FORCA JONË

*** Viti I • Nr.1 • Qershor 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës***

Fjala e ministrit të MFSK-së Agim Çekut për numrin e parë të gazetës „Forca Jonë“

Qytetarët duhet të informohen për FSK-në

Që në fillim të mandatit tim, unë i publikova objektivat, të cilat u zotova se do t'i realizoj së bashku me të gjithë pjesëtarët civil dhe ushtarak të MFSK-së, gjatë mandatit tim si ministër për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Këto objektiva janë në përputhje me objektivat e Qeverisë së Kosovës. Arritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO), si objektiv i parë, ka qenë sfida më e madhe. Ne jemi duke punuar pa u ndalur në ngritjen dhe zhvilliminne këtyre kapaciteteve, ndërkohë që presim mbështetjen politike nga Brukseli për rekomandimin e KFOR-it për arritjen e KPO-ve, në mënyrë që NATO të shpallë se FSK-ja i ka arritur ato. Rrjedhimisht, ne si MFSK duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimve globale në fushën e sigurisaë, jemi duke u përgatitur për fazën e pas arritjes së Kapaciteteve të Plota Operaciona. Me ushtrimin fushor „Shqiponja-1“, FSK-ja ka dëshmuar pjekurinë profesionale, gatishmërinë për t'u përballur me të gjitha sfidat vendore ku është e obliguar të reagojë sipas ligjit. Duke mos lejuar shkëputjen nga e kaluar jonë, ne kemi ndërmarrë disa veprime në MFSK, për të cilat mund të thuhet se janë themel i një tradite të mirëfilltë për ruajtjen e identitetit tonë. Disa nga këto janë manifestimet e 5, 6 dhe 7 Marsit, Ditës së Forcës 27 Nëntorit, ndryshimi i uniformës, emërimi i kazermave etj. Përgjegjësia jonë ndaj shtetit dhe qytetarëve është dëshmuar me reagimet e ndryshme të njësiteve tona në raste të emergjencave si në tragjedinë e Restelicës, në raste të vërshimeve, në gjetjen e personave të zhdukur etj. Departamenti për Bashkëpunim Civil-Ushtarak është shumë aktiv në ofrimin e ndihmës për qytetarët e Kosovës, si në ndërtimin e rrugëve, sidomos në vendet rurale, ofrimin e ndihmës mjekësore për pjesëtarët e minoriteteve dhe aktivitete të tjera të karakterit kulturor e humanitar. Në frymën e sigurisë rajonale, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës është duke u përgatitur për të themeluar Qendrën e Ekselencës për Kërkim-Shpëtim. Kjo qendër trajnuese do të kontribojë në sigurinë e përgjithshme rajonale dhe më gjerë duke ofruar njësite të specializuara e të trajnuara për kërkim-shpëtim në të gjitha vendet e rajonit në rast nevoje, si dhe në vendet tjera anëtare të NATO-s sipas marrëveshjeve të ardhshme dypalëshe. Ne, po ashtu mburremi me njësitin për deminim i cili është shumë aktiv dhe i suksesshëm, jo vetëm në pastrimin e vendëve të dyshimta që ende mund të kenë mina nga lufta e fundit, por edhe në edukimin e popullatës për ngritjen e vetëdijes lidhur me rrrezikun nga minat. Shpresojmë që në të ardhmen, ky njësit të jetë po ashtu një ndër njësitet më të përgatitura për misione paqeruajtëse jashtë vendit. Unë që në fillim të mandatit tim, kam cekur rëndësinë e krijimit të një force me standarde ndërkombëtare të NATO-s, por me identitet të dallueshëm kombëtar dhe vendor. Pjesë e rëndësishme e realizimit të këtij objektivi, është edhe paraqitja publike e forcës sonë. E kjo, në këtë shekull ku dominon teknologjia e informimit, bëhet më së miri ndërmjet mediumeve të caktuara, në këtë rast me atë të shtypit.



Ne e dimë, se qytetarët e Republikës së Kosovës janë përkrahës të fuqishëm të FSK-së dhe pikërisht për këtë arsye u mor vendim që të bëhet publikimi i gazetës "FORCA JONË". Ashtu siç mund të kuptohet edhe nga vet emri i saj, ne do të angazhohemi që të jemi sa më afër publikut dhe ta informojmë sa më shpejtë dhe më mirë, duke marrë parasysh interesimin që kanë për zhvillimet në FSK.

Unë e përkrahi me të gjitha mundësitë e mia këtë nismë të Departamentit për Marrëdhenie me Publikun dhe uroj, që kjo nismë të zhvillohet dhe avancojë në një revistë të ilustruar dhe të pavarur, ku do të trajtoheshin tema të ndryshme nga fusha e sigurisë dhe aktivitetet e MFSK-së dhe FSK-së.

Fjala e botuesit

Departamenti për Marrëdhënie me Publikun i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të fillojë botimin e një gazete, shtojcë mujore. Ky projekt është bërë me vendim të datës; 7.06. 2012, Nr. 37/01/2012, të lëshuar nga ministri i FSK-së, Agim Çeku. Gazeta „Forca Jonë“, do ta mbajë emrin që lidhet me emrin e institucionit tonë, duke qenë i bindur se është emër simbolik dhe do t'i rezistojë edhe ndryshimeve në mision dhe detyra të MFSK-së dhe FSK-së.



Gazata do të jetë e dobishme që të ofrojë informacionin tek publiku i gjerë dhe te taksapaguesit, me çka do të rritej transparenca për punën dhe aktivitet e Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Në prespektivë gazeta „Forca Jonë“ do të ndryshojë dhe transformohet në revistë të ilustruar ushtarake. Si botues dhe redaksi jemi të hapur për bashkëpunim me të gjithë ata që kanë prirje dhe dëshirë për të shkruar si bashkëpunëtorë të jashtëm. Gazeta do të jetë në 8 faqe, do të botohet dhe shpërndahet si shtojcë e gazetës ditore „Epoka e re“. Ju ftojmë që të punojmë së bashku për „Forca Jonë“.

Së bashku jemi më të fortë.

Komandanti i FSK-së ka pritur një delegacion të oficerëve të Shqipërisë

Bazuar në Planin Bilateral të bashkëpunimit në mes Ministrisë së FSK-së dhe të Ministrisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për një visitë zyrtare, dy ditore, ka qëndruar një delegacion i oficerëve të lartë të Shqipërisë në Ministrinë e FSK-së. Delegacionin e Shqipërisë e priti komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me bashkëpuntorë, i cili udhëhiqej nga koloneli Avdi Hankollari, shef i Degës së Standardizimit dhe Ndërtëveprimit të KDS-së, etj. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati e njoftoi delegacionin ushtarak të Shqipërisë, me procesin e zhvillimit të FSK-së, dhe njëheritë e falenderoi Shqipërinë për bashkëpunimin dhe për mbështetjen që po jep për zhvillimin e FSK-së, në fusha të ndryshme.



Më pastaj të dy delgacionet kanë vazhduar takimet punuese në fushën e standardizimit dhe në fushën e emergjencave. Delegacioni ushtark në përmbyllje të vizitës zyrtare ka qëndruar në Kompleksin Memorial të Komandantit Legjendar Adem Jashari në Prekaz, ku kanë vendosyur lule dhe kanë bërë homazhe në nderim të jetës dhe veprës së tyre.

John Menzies ish-ambasadori amerikan në Kosovë, vizitoi FSK-në

John Menzis erdhi në cilësinë e rektorit të Universitetit „Seton Hall“ nga shkolla për diplomaci dhe marrëdhënie ndërkombëtare „John C. Whitehead“ në New Jersy të SHBA-ve, së bashku me profesorë dhe studentë të tij. Gjatë vizitës në Ministrinë e FSK-së, ata u interesuan për të arriturat e FSK-së dhe të ardhmen e saj.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, në mënyrë kronologjike i ka njoftuar profesorët dhe studentët e Amerikës për zhvillimet e FSK-së, të arriturat profesionale, plotësimin e kapaciteteve operacionale, bashkëpunimin në rajon dhe në veçanti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e sidomos me Gardën Kombëtare të AJOVES. John Menzis me këtë rast, ka falenderuar ministrin Çeku, për pritjen miqësore, dhe pos tjerash, ka thënë se ne kemi shumëçka të përbashkët, andaj edhe me shumë dëshirë vijmë këtu në Kosovë.

Ministri Çeku në fund me dëshirë iu është përgjigjur pyetjeve të shumta të studentëve dhe profesorëve amerikanë për zhvillimet e FSK-së dhe të ardhmen e saj.

Ministri Çeku në një pyetje të studentëve amerikanë, për të ardhmen e FSK-së, pos tjerash ka thënë, se: në verën e vitit të ardhshëm do të dalim me një rekomandim, pasi Ai, po e kryeson grupin për Rishikimin e Sektorit të Sigurisë. „Ky rishikim është duke u bërë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar e sidomos me SHBA-të“ tha në fund ministri Agim Çeku.

Qëllimi i vizitës së profesorëve dhe studentëve amerikanë, në Kosovë, është përgatitja e temave shkencore për Kosovën dhe në veçanti për Forcën e Sigurisë të Kosovës.

Komiteti i Mbrojtjes së Bundestagut të Gjermanisë vizitoi MFSK-në

Ministri Agim Çeku dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati priten sot në MFSK, Kryetaren e Komitetin të Mbrojtjes së Bundestagut të Gjermanisë, zonjën Susanne Kastner dhe përfaqësues të tjerë të Komitetit të Mbrojtjes.

Gjatë takimit, ministri Çeku shprehu kënaqësinë për vizitën e delegacionit të Komitetit të Mbrojtjes të Gjermanisë, si edhe shprehu falënderimet për Qeverinë dhe popullin gjerman për përkrahjen e pakursyer për Kosovën e në veçanti për FSK-në. Po ashtu ministri i FSK-së, Agim Çeku kërkoi nga zonja Kastner përkrahje në arritjen dhe konkretizimin e marrëveshjes bilaterale me Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë.
Ndërsa kryetarja e Komitetit të Mbrojtjes së Gjermanisë, zonja Susanne Kastner u interesua për zhvillimet në FSK, si edhe në përgjithësi për fushën e sigurisë në Kosovë.
Në takim me delegacionin gjerman, pos ministrit dhe komandantit, morën pjesë edhe zëvendësministri Shemsi Veseli, gjeneral brigade Zymer Halimi si edhe Besa Kabashi-Ramaj, Këshilltare e lartë Politike e ministrit Çeku.Delegacioni i Komitetit të Mbrojtjes së Bundestagut Gjerman përfaqësohej nga: Kryetare e Komitetit të Mbrojtjes, Susanne Kastner dhe anëtare e Bundestagut Gjerman, Dr. Ernst Reichel- Ambasador i Ambasadës gjermane në Prishtinë si edhe aanëtarët e Bundestagut gjerman: Michael Brand, Jurgen Hardt, Rainer Erdel.



Susanne Kastner, kryetare e Komitetit të Mbrojtjes së Bundestagut të Gjermanisë vizitoi MFSK-në

Ministri Agim Çeku dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati priten në takim kryetaren e Komitetit të Mborjtjes se Bundestagut të Gjermanisë, Susanne Kastner. Ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati shprehen kënaqësinë për vizitën e këtij Komitetit, si edhe falënderuan Qeverinë dhe popullin gjerman për përkrahjen e pakursyer për Kosovën e në veçanti për FSK-në. Ministri i FSK-së, Agim Çeku kërkoi nga zonja Kastner përkrahje në arritjen dhe konkretizimin e marrëveshjes bilaterale me Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë. Ndërsa kryetarja e Komitetit të Mbrojtjes së Gjermanisë, Susanne Kastner u interesua për zhvillimet në FSK, si edhe në përgjithësi për fushën e sigurisë në Kosovë.



Gjeneral Kastrati priti në një vizitë lamtumirëse atasheun ushtarak të Japonisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Kadri Kastrati, priti në një vizitë lamtumirëse, kolonel Junji Koitabashi, atashe ushtarak i Japonisë në Vjenë, i cili e mbulon edhe Kosovën.
Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati me këtë rast e ka falënderuar atasheun ushtarak kolonelin Junji Koitabashi për bashkëpunimin e deritashëm dhe ndihmën që Japonia po jep për FSK-në.
Atasheu Koitabashi ka premtuar se edhe pasardhësi i tij, do të vazhdojë bashkëpunimin e mirë me FSK-në, dhe premtoi se mbështetja e Japonisë për FSK-në, nuk do të mungojë edhe në të ardhmen.

Komandanti i FSK-së takon komandantin e Forcave Tokësore të Italisë

Ministri dhe komandanti i FSK-së, Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrat, në Ministrinë e FSK-së, kanë pritur në një vizitë zyrtare komandantin e Forcave Tokësore të Italisë, gjenerallejtënant Roberto Bernadini i cili shoqërohej nga generalbrigade Scollo Luigi Paolo dhe Francesko Diella.
Me këtë rast, ministri i FSK-së Agim Çeku e ka falënderuar komandantin e Forcave Tokësore të Italisë, gjeneralin Roberto Bernadini, për ndihmën që shteti i tij, Italia ka bërë për shtetin e Kosovës dhe në veçanti për FSK-në.
Më pastaj ministri Çeku e ka njoftuar komandantin e Forcave Tokësore të Italisë, për arritjet e FSK-së, në përmbushjen e objektivave dhe të kapaciteteve operaionale, me trajnimet, shkollimin dhe pjesëmarrjen e FSK-së, në trajnimet e ndryshme në shtetet me të cilat FSK-ja, ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi.
Gjithashtu ministri Çeku e ka njoftuar komandantin e Ushtrisë Tokësore të Italisë për objektivat për vitin 2012, për bashkëpunimin bilateral dhe multiteral- kërkesën drejtuar Italisë për ndikimin e saj, për ta ndihmuar anëtarësimin e FSK-së, në organizmat ndërkombëtar dhe në NATO.
Komandanti i Forcave Tokësore të Italisë, gjenerali Bernandini ka shprehur kënaqësinë e veçantë për punën që po bënë FSK-ja, në përgjithësi, për trajnimet dhe për arritjet në realizimin e kapaciteteve të përgjithshme të FSK-së. Ai ka premtuar, që edhe në të ardhmen, ta ndihmojë FSK-në, në të gjitha fushat me interes të përbashkët.



Zëvendësministri Bejtush Gashi kërkoi anëtarësimin e FSK-së, në organizatat rajonale të sigurisë

Me ftesë zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, një delegacion i Ministrisë së FSK-së, përfaqësuar nga zëvendësministri Bejtush Gashi, ka marrë pjesë, në takimin e njëzeteshtatë, të Grupit Këshillues Ndërkombëtar dhe Buxhetit (MAG), të mbajtur në Durrës, nga data 18-19 prill 2012, në të cilën morën pjesë 15 delegacione të shteteve anëtare, të asociuara dhe vëzhguese si dhe dy organizata rajonale.
Qëllimi i pjesëmarrjes së delegacionit të Ministrisë së FSK-së, ishte konfirmimi i kërkesës së Kosovës, që të bëhet pjesë në të gjitha nismat rajonale, përfshirë këtu edhe RACVIAC.
Takimi u kryesua nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneral brigade Zyber Dushku.

Me marrëveshjen e re të ratifikuar më datë 1 dhjetor 2011, dhe që ka hyrë në fuqi, RACVIAC është një qendër për kooperimin në fushën e sigurisë, e cila do të vazhdojë punën drejt realizimit të objektivave të reja.
Ndërsa, zëvendësministri i FSK, Bejtush Gashi shprehu vullnetin politik dhe angazhimin e Kosovës, të FSK-së, dhe kërkoi që kërkesa e ministrit Agim Çeku, duhet të konsiderohet e pranuar për anëtarësimin e MFSK-së, me qëllim të kontributit të saj, në nismat dhe iniciativat rajonale, për një bashkëpunim të mëtejshëm e sa më të frytshëm rajonal, ku një rol të rëndësishëm luan RACVIAC.

Ministri i Mbrojtjes i Italisë Giampaolo Di Paola vizitoi Ministrinë e FSK-së

Ministri Agim Çeku dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati pritën ministrin e Mbrojtjes të Italisë, Giampaolo Di Paola të shoqëruar nga ambasadori i Republikës së Italisë në Prishtinë, Michael Giffoni.



Ministri i FSK-së, Agim Çeku shprehu kënaqësinë e veçantë për vizitën e ministrit të Mbrojtjes të Italisë, z. Giampaolo Di Paola, si edhe shprehu falënderimet për Qeverinë dhe popullin italianë, për përkrahjen e pakursyer për Kosovën e në veçanti për FSK-në.

Ministri Agim Çeku me këtë rast e njoftoi homologun e tij, me zhvillimin e FSK-së, me të arriturat, me objektivat, me vizionin e zhvillimit dhe me sfidat që po përballet FSK-së.

Pas takimit ministri i FSK-së Agim Çeku deklaroi se marrë mbështetje nga ministri Di Paola për agjendën e Kosovës për bashkëpunimin rajonal si edhe për agjenden e Kosovës për në NATO. Ministri Çeku shprehu besimin për mbështetje pikërisht bazuar në autoritetin e admiralit Di Paola si njohës i mirë i zhvillimeve në FSK dhe Kosovë.

Ministri z. Giampaolo Di Paola deklaroi se Italia do të vazhdojë të angazhohet që të jetë prezente në Kosovë dhe të ndihmojë Kosovën edhe më tej, deri sa Kosova dhe i tërë Ballkani të integrohen në Evropë, duke premtuar se këtë rrugëtim do ta bëjmë së bashku. Sikurse deri më tash edhe në të ardhmen, Kosova mund të llogarisë në ndihmën e Italisë.

Garda Kombëtare e IOWA-s do ta ndihmojë FSK-në

Ministri dhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati kanë pritë në një takim pune, shefin e Shtabit të Gardës Kombëtare të IOWA-s, kolonelin Gary Freese.

Kjo vizitë u realizua në kuadër të thellimit të bashkëpunimit pas nënshkrimit të partneritetit shtetëror për bashkëpunimit në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të IOWA-s.

Ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me këtë rast e kanë falënderuar SHBA-n dhe Gardën Kombëtare të IOWA-s, për ndihmën që po japin për FSK-në.

Ministri dhe Komandanti i FSK-së, gjithashtu e kanë njoftuar Shefin e Shtabit të Gardës Kombëtare të IAWA-s, kolonelin Freese për zhvillimet dhe të arriturat e Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe për objektivat e zhvillimit të FSK-së, për të ardhmen.

Shefi i Shtabit të Gardës Kombëtare të IOWA-s, qëndroi në Kosovë, me një ekip nga IOWA dhe EUCOM-i, për caktimin e fushave të bashkëpunimit bilateral, për vitin 2013.

Koloneli Gary Freese, ka premtuar që edhe në të ardhmen, Garda Kombëtare e IOWA-s, do ta ndihmojë FSK-në, në të gjitha drejtimet.



FSK-ja, EUCOM-i dhe Garda Kombëtare e IOWA-s, caktojnë prioritetet për vitin 2013

Bazuar në bashkëpunimin që MFSK-ja dhe FSK-ja kanë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi edhe partneritetin me Gardën Kombëtare të IOWA-s, dje ministri dhe komandanti i FSK-së, Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati kanë takuar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Gardës Kombëtare të IOWA-s, kolonel Gary Fresse, ndërsa sot, vazhdoi takimi punues, në mes të delegacionit të FSK-së dhe të delegacionit EUCOM-Garda Kombëtare të IOWA-s, me qëllim të koordinimit të prioriteteve për bashkëpunim, për vitin 2013.

Delegacionin e FSK-së, e udhëhoqi koloneli Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim të FSK-së, dhe nga Brian Driggers drejtoria e Strategjive dhe Partneritetit J-5, të EUCOM-it.

Takimi punues i të dy delegacioneve është bërë për caktimin e prioriteteve të FSK-së, për vitin 2013, me qëllim të shkollimit, trajnimeve dhe të ushtrimeve të përbashkëta për ngritjen profesionale të FSK-së, për tre mujorin e fundit të vitit 2012 dhe vitin 2013.

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë vizitoi MFSK-në

Qëllimi i vizitës së sotme i Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë në Kosovë dhe në Ministrinë e Forcës Mbrojtëse të Kosovës, ishte vazhdimi i bashkëpunimit të dyanshëm, në mes të FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë, në sferat e ndryshme me interes të përbashkët, si: në sferën e sigurisë, të mbrojtjes, të shëndetësisë, në trajnime të ndryshme ushtarake dhe në kontributin e përbashkët me qëllim të ruajtjes së paqes në rajon.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, në deklarimin para medieve, ka falënderuar shtetin dhe ushtrinë shqiptare për të gjitha kontributet e dhëna dhe mbështetjen që po i jep Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri Çeku me këtë rast, tha: Ministria dhe FSK-ja ka një bashkëpunim të mirë me Ushtrinë e Shqipërisë një bashkëpunim shumë dinamik dhe një bashkëpunim shumë të frytshëm. Shqipëria është ndër vendet që më së shumti



e mbështet FSK-në, por edhe Kosovën. Ky takim kaloi në frymën e bashkëpunimit vëllazëror, ne i falënderohemi për mbështetjen që po i jep FSK-së, gjithashtu i intensifikuam fushat e reja të bashkëpunimit që sa më sukses t'i përballojmë sfidat, gjithashtu e njoftova ministrin edhe me të arriturat tona, me angazhimin tonë, me objektivat tona, me vizionin tonë dhe kërkuam mbështetje në të gjitha rrafshet si në rrafshin bilateral dhe në rrafshin rajonal, në rrafshin e integrimit në NATO, etj, ne morën një mbështetje të fuqishme dhe u dakorduam për hapa konkret që duhet t'i ndjekim menjëherë që nga dita e nesërme, që ne të ecim më hapa konkretë në realizimin e misionit që kemi. Ne i kërkuam ministrit Imami që Shqipëria të jetë lobuese e FSK-së, në NATO-s.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Arben Imami ka falënderuar ministrin e FSK-së, Agim Çeku për mikpritjen e ngrohtë dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejmë, për përmbushjen e synimeve të FSK-së, drejt anëtarësimit në të gjitha organizmat e NATO-s.

Ministri Imami premtoi ndihmë për FSK-në, i cili me këtë rast, tha; "Mund të llogaritni në Republikën e Shqipërisë, Ministrinë e Mbrojtjes, në drejtim të avancimit të reformave të cilat ju po bëni e keni partner në të gjitha iniciativat, si në planin bilateral në këmbim të përvojave ashtu edhe në planin e plotë të pjesëmarrjes së Kosovës, në iniciativat rajonale, si dhe në rrugën të cilën ju po bëni për integrim në Strukturat Euro Atlantike, të gjitha këto në funksion të paqes dhe të stabilitetit në rajon, një paqe të qëndrueshme dhe ta bëjmë rajonin pjesë e cila do t'i kontribuojë paqes, jo vetëm në rajon por edhe në nivel global, në atë që është parim i NATO-s dhe parim i partneritetit.

Imami tha se marrëdhëniet tona janë të shkëlqyera dhe se puna e përbashkët është shumë e mirë dhe ky bashkëpunim në fund të fundit shkon në favor të paqes dhe stabilitetit të tërë rajonit. Kemi një vlerësim shumë pozitiv të rritjes së kapaciteteve operacionale të FSK-së, jemi shumë të lumtur që Komanda e Napolit ka bërë një raport të shkëlqyer vlerësimi për ngritjen e këtyre kapaciteteve dhe kjo hap rrugën që FSK-ja të bëhet një forcë mbrojtje konvencionale. Ne shpresojmë se menjëherë pas samitit të Çikagos të futet menjëherë në agjendë, Republika e Shqipërisë do të këmbëngul për këtë gjë.

Pas konferencës për media, të dy delegacionet morën pjesë në Koncertin që dha Banda frymore e Ushtrisë së Shqipërisë, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë, e më pastaj edhe në Sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë, ku morën pjesë shumë qytetarë, për ta përcjellë Bandën frymore të Ushtrisë të Republikës së Shqipërisë. Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Arben Imami u prit me nderime ushtarake nga Togu Ceremonial i FSK-së..

Kolonel Ilaz Derguti emërohet komandant i Brigadës së Mbështjes Operacionale

Në Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) u mbajt Ceremonia e ndërrimit të komandantit të Brigadës së Mbështetjes Operacionale(BMO).

Ceremonia e ndërrimit të komandantit të BMO-së, filloi me intonimin e Himnit shtetërorë, dhe me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të BMO-së, nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe komandanti i BMO-së, gjeneral brigade Imri Ilazi.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati fillimisht, për merita të jashtëzakonshme i ndau Medalje, gjeneral brigade Imri Ilazit, komandantit të deritanishëm të BMO-së. Komandanti më këtë rast solemn foli për të arriturat e FSK-së, për punën e deritanishme të gjeneral brigade Imri Ilazit dhe kolonel Ilaz Dërgutit, të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së.

Në ceremoninë e ndërrimit të komandës së BMO-së, morën pjesë; ministri i FSK-së, Agim Çeku, zëvendësministrat e FSK-së, Shemsi Veseli, Bejtush Gashi dhe Sllavisha Filipoviq, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zv. komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ambasadorë dhe atashe të akreditуar, në vendin tonë, oficerë të FSK-së dhe të KFOR-it, personalitet politike, kulturore, nxënës të shkollave fillore dhe qytetarë të shumtë.

Në fund gjeneral Ilazi ka falënderuar ministrin e FSK-së, komandantin dhe të gjithë oficerët, nënoficerët dhe ushtarët e FSK-së, për mbështetjen gjatë tërë kohës, sa ka shërbyer si Komandant i BMO-së, ka falënderuar edhe KFOR-in, NATO-n dhe personalitetet vendore e ndërkombëtare, që ndihmuan në zhvillimin e FSK-në, dhe të BMO-së. Në fund, u zhvillua ceremonia e pranimdorëzimit të flamurit-detyrës së Komandantit të ri të BMO-së. Këtë ceremoni e udhëhoqi komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Më pastaj u bë parakalimi i eshalonëve të Brigadës së Mbështetjes Operacionale.

FORCA JONË

Forca e Sigurisë së Kosovës realizoi ushtrimin më të madh fushor "Shqiponja -1"

Shqiponja konfirmoi plotësimin e kapaciteteve operacionale

Ushtrimi fushor është planifikuar dhe realizuar plotësisht nga FSK-ja. Të gjithë pjesëtarët e FSK-së, mbi 2300 pjesëtarë, kanë marrë pjesë në mbi 40 operacione në terren. Ushtrimi fushor është vlerësuar shumë i suksesshëm nga KFOR-i.



Forca e Sigurisë së Kosovës me operacionin e kërkim-shpëtimit në ujëra ka përmbyll realizimin e ushtrimit më të madh fushor "Shqiponja-1", që u mbajt në javën e fundit të muajit Prill.

Ushtrimi fushor është planifikuar dhe realizuar tërësisht nga Komanda e Forcave Tokësore (KFT), në nivel Brigade të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ku sipas skenarit; janë inskenuar një varg incidentesh, si: tërmete, aksidente, shtrëngata, vërshime dhe përmbytje në pjesën lindore dhe perëndimore të Kosovës, gjegjësisht në rajonin e Gjilanit, Pejës dhe Prizrenit.

Forca e Sigurisë së Kosovës si gjatë planifikimit njashtu edhe gjatë realizmit të ushtrimit "Shqiponja-1" në terren, dëshmoi shkallë të lartë; disiplinë, seriozitet dhe profesionalizim, të gjithë 2300 pjesëtarët e angazhuar në operacion, me rreth 200 automjete, kanë kryer detyrat në një terren të gjerë në lindje dhe perëndim të Kosovës, duke mos dëmtuar asnjë pronë të qytetarëve dhe as lëvizjen e tyre.

Dhënia e alarmit, më 19 prill, për gjendje gatishmërie, zyrtarisht edhe shënoi fillimin e realizimit të ushtrimit, "Shqiponja-1" ku të gjithë pjesëtarët e FSK-së, qysh në orët e hershme të mëngjesit, kishin filluar realizimin e detyrave operacionale dhe deri më 30 prill edhe kur përfundoi ushtrimi, pjesëtarët e FSK-së dëshmuan përgatitje të lartë profesionale në terren, dhe realizuan në tërsi skenarin e ushtrimit, gjatë intervenimit, në më shumë se 40 aksidente.

Për të përcjellë rrjedhat e ushtrimit, si vendislokimin e njësive të FSK-së, në Xerxë, dhe operacionin nga Ura e Shenjtë, ishte ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, shefi i Divizionit Këshillues Ushtarako-Civil të NATO-s, gjeneralbrigade Francesko Diella, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it.

Në Komandën e vendicidentit të Ushtrimit "Shqiponja -1", para ministrit, komandantit dhe eprorëve të lartë, një prezantim për rrjedhën e përgjithshme të operacioneve e bëri drejtori i ushtrimit, koloneli Naim Haziri, shef i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, i cili njoftoj se operacionet e gjithëmbarshme të Ushtrimit "Shqiponja-1" po realizohen sipas planifikimit dhe se rezultatet në terren janë të shkëlqyeshme.


Ministri i FSK-së Agim Çeku, së bashku me gjeneralët: Kadri Kastrati, Francesko Diella, Gëzim Hazrolli, Nazmi Brahimaj, Bashkim Jashari, Imri Ilazi, kolonel Naim Haziri, etj, vizituan njësitetet e FSK-së, gjatë reagimit në ujëra, tek Ura e Shenjtë. Aty zyrtarët dhe ushtarakët e lartë panë demonstrimin praktik të njësiteve të kërkim-shpëtimit, etj.

Pas intervenimit të njësive të FSK-së, ministri Agim Çeku vlerësoi se FSK-ja me këtë ushtrim demonstroi profesionalizmin të lartë, përkushtimin dhe motivimin në realizimin e detyrave në terren.

Ministri Agim Çeku, pos tjerash tha: "me këtë ushtrim u dëshmua qëndrueshmëria e lartë e njësive të









Gjeneralbrigade Francesko Diela shef i Divizionit Këshillues Ushtarako-Civil të NATO-s, u shpreh shumë i entuziazmuar me operacionet e zhvilluara nga FSK-ja gjatë Ushtrimit fushor "Shqiponja-1". "FSK-ja përmbushi edhe një detyre të rëndësishme dhe e kaloi me sukses atë. FSK-ja demonstroi dhe konfirmoj kapacitetet e saja operacionale dhe se është e gatshme ta ndihmojë popullin e Kosovës, ashtu siç e ka dëshmuar edhe me rastin e fatkeqësisë në Restelicë". Në përmbyllje të fjalës së tij, gjenerali Diella, tha, se: "gjatë këtyre operacioneve të FSK-së ka parë me sytë e tij, motivimin e lartë që dëshmuan pjesëtarët e FSK-së dhe rikonfirmimin se FSK-ja është institucioni më i rëndësishëm në Kosovë".

dhe arritjet e nivelit më të lartë të standardeve profesionale



FSK-së, jashtë kampeve, e cila dëshmoi shkallë të lartë disiplinë dhe seriozitetet, të gjithë, 2300 pjesëtarët e angazhuar në operacion, me rreth 200 automjete i kryen detyrat në një terren të gjerë në lindje dhe perëndim të Kosovës, duke mos dëmtuar asnjë pronë të qytetarëve dhe as lëvizjen e tyre.

FSK-ja edhe një herë dëshmoi se i përmbushur në plotni Kapacitetet e saj Operacionale dhe se është e gatshme të marrë edhe detyra shtesë".

Ndërsa komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, për zhvillimet e ushtrimit nga njësitet e FSK-së, në terren, tha: "FSK-ja ka realizuara dyzet (40) operacione me sukses, për vetëm katër ditë, ushtrimet janë zhvilluar si ditën edhe natën, në terrene të ndryshme. FSK-ja përmes këtij ushtrimi po dëshmonë se Ushtrimi "Shqiponja-1" po i afrohet përfundimit me rezultate të shkëlqyeshme. FSK-ja është jashtëzakonisht e përgatitur për t'i kryer detyrat që aktualisht i ka në mision".

Forca e Sigurisë të Kosovës, që nga data; 20 prill 2012, ku filloi realizimin e ushtrimit fushor "Shqiponja 1" i cili ushtrim sipas planifikimit, pritet të kryhet më 30 prill 2012, ka realizuar mbi 40 operacione të ndryshme dhe terrene të ndryshme.

Ushtrimi fushor është planifikuar dhe realizuar nga KFT-ja, ku sipas skenarit ishin inskenuar një varg incidentesh, si: tërmeti, në rajonin e Gjilanit, shtrëngata, vërshime dhe përmbytje në rajonin e Pejës-Prizrenit, etj, pastaj fusha të minuara të përcjella me lirimin e materieve të rrezikshme, etj. Gjatë këtij ushtrimi, sipas situatave, njësitet e FSK-së, treguan aftësitë reaguese dhe profesionale.

Ushtrimi u vëzhgua dhe u vlerësua edhe nga ekipet e përbashkëta të FSK-së, NATO-s (KFOR-it).

Qëllimi i ushtrimit fushor "Shqiponja -1" ishte arritja e aftësive profesionale si dhe testimi i kapaciteteve të FSK-së, për menaxhimin dhe realizimin e ngjarjeve, gjatë krizave të mundshme. Me këtë ushtrim FSK-ja arriti në tërsi realizimin e objektivave të parashtruara nga Stafi Komandues. Synimi ishte që të marrin pjesë të gjithë pjesëtarët e FSK-së, në ushtrim sipas nivelit të përgjegjësive në mënyrë që të shtohen aftësitë për të planifikuar, koordinuar dhe vepruar në situata reale, si dhe të forcohet bashkëpunimi dhe puna ekipore brenda stafit drejtues-vendimmarrës të njësive pjesëmarrëse në ushtrim.



Trajnime të përbashkëta KFOR-FSK

KFOR-i Amerikan trajnon pjesëtarë të FSK-së, me helikopter, për evakuime mjekësore

Prishtinë, 30 maj 2012 - Në terrenet e Kazermës "New Born"të FSK-së, në Gjilan, KFOR-i Amerikan për dy ditë ka trajnuar pjesëtarë të FSK-së, me helikopter.

Në këtë ushtrimin kanë marrë pjesë tridhjetë e katër pjesëtarë të FSK-së, 21 pjesëtarë nga Kompania e Kërkim-Shpëtimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) si dhe 13 pjesëtarë nga Njësia Ndërlidhëse e Reagimit të Krizave (NJNRK).

Trajnimi ka filluar më 28 maj dhe ka përfunduar më 29 maj 2012, temat më të rëndësishme kanë qenë; plotësimi i kërkesë për evakuim mjekësor, ngritja dhe zbritja me pacientë nga helikopteri, përzgjedhja dhe përgatitja e terrenit për aterrim, etj.

Për të përcjellë nga afër trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së, mori pjesë edhe komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale, kolonel Ilaz Dërguti, me bashkëpunëtorë.

Me këtë rast, kolonel Dërguti ka falënderuar stafin e KFOR-it Amerikan, majorin Turk Ozcan Kuzeyi dhe ndihmësit e tij, për angazhimin dhe punën e palodhshme që po bëjnë për trajnimin dhe aftësimin e pjesëtarëve të FSK-së, për tu dalë në ndihmë qytetarëve, në raste emergjente, ndërsa i ka inkurajuar pjesëtarët e FSK-së, për trajnime sa më cilësore dhe të jenë të vëmendshëm, pasi është hera e parë që pjesëtarët e FSK-së, po marrin pjesë në një ushtrim të tillë.

Pas përfundimit të ushtrimit, të gjithë pjesëtarët e FSK-së, janë pajisur me certifikata. Ky është trajnimi i parë i pjesëtarëve të FSK-së me helikopter, e që ka pas për qëllim përgatitjen e FSK-së, për evakuimin e qytetarëve në raste të katastrofave natyrore.



Trajnim i përbashkët i FSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë, në Ankara

FSK-ja e gatshme për pjesëmarrje në Operacione Mbështetëse të Paqes në Botë



Brigada 28 e Korpusit të Tretë të Forcave të Armatosura të Ushtrisë së Turqisë, ka trajnuar, në Qendrën e Partneritetit për Paqe, në Ankara,
ku 33 pjesëtarë të FSK-së, për mbështetje të operacioneve paqësore, në Botë.
Me rastin e certifikimit mori pjesë edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati i cili vlerësoi trajnimin me standarde të NATO-s,
Në bazë të Marrëveshjes Bilaterale për Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së FSK-së dhe të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, një Togë prej 33 pjesëtarëve të FSK-së, për një muaj kanë kryer trajnimet për Operacione Mbështetëse të Paqes, në Turqi.
Me rastin e nisjes të pjesëtarëve të FSK-së, për në Turqi, ministri i FSK-së, Agim Çeku u shprehë se ndjehet tejet i lumtur që Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Turqisë



dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë së Turqisë, kanë ofruar mundësi trajnimi për FSK-në, trajnime të nivelit të lartë për Operacione Mbështetëse të Paqes, dhe kjo po ndodh pikërisht në repartet dhe pilogonet ushtarake të Ushtrisë së Turqisë. Gjithashtu edhe koloneli Yucel Keles, përfaqësues i Ushtrisë Turke në Kosovë, shprehu kënaqësinë që ky projekt që buron nga Marrëveshja Bilaterale e Bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë Turke po realizohet dhe se trajnimi i FSK-së për Operacione Mbështetëse të Paqes është njëra prej formave të mbështetjes që Ushtria e Republikës së Turqisë ka ofruar për FSK-në.
Në ceremoninë e certifikimit të Togut të FSK-së, në Ankara, mori pjesë edhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me komandantin e Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, gjeneralbrigade Nazmi Brahimaj.
Komandanmti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati përcolli nga afër trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së dhe ceremoninë e certifikimit. Gjeneral Kastrati u nda shumë i kënaqur me përformansën e pjesëtarëve të FSK-së, të cilët për një muaj, sa u trajnuan në Brigadën e 28 të Korpusit të Tretë të Forcave të Armatosura të Ushtrisë së Turqisë, në Ankara, realizuan trajnime të nivelit të lartë dhe me standarde të NATO-s.
Përgatitja e Togut të FSK-së, u bë me qëllim të pjesëmarrjes së FSK-së, në Operacione Mbështetëse të Paqes. Pjesëtarët e FSK-së u vlerësuan me notën më të lartë, nga Oficeret e Ushtrisë së Turqisë dhe ekspert të kësaj lamie. Në fund komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati ka falenderuar Ushtrinë e Turqisë, për ndihmen e madhe dhe të pakursyer që po japin për FSK-në.

Njësia Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave e FSK-së mbajti një ushtrim fushor në Danimarkë

Njësia Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave(NJNRK) e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjatë muajit prill, ka marrë pjesë një ushtrim fushor të koduar "Miqësia 2012" në Danimarkë. Ushtrimi është realizuar në qytetin Tiglev të Mbretërisë së Danimarkës.
Të gjithë pjesëtarët e Njësisë për Reagim të Krizave, morën pjesë në këtë trajnim, ku sipas skenarit, NJNRK-ja ka kryer planifikimin, organizimin, implementimin, realizimin dhe ekzekutimin e ushtrimit fushorë, në të cilin, pas një tërmeti me përmasa të gjera, dhe si pasojë e tërmetit, ka pasur një serë incidentesh dhe shkatërrime të tjera.
Ky trajnim është mundësuar dhe realizuar nga Qeveria e Danimarkës, falë punës dhe bashkëpunimit të gjithanshëm me ushtarakët mentorues danez.
Qëllimi i ushtrimit ishte ngritja e aftësive profesionale si dhe pavarësimi për realizimin e ushtrimeve të tilla. Esenca e zhvillimit të ngjarjeve ishte aftësimi i Njësisë në krijimin e Qendrës Koordinuese për Menaxhimin e Ndërhyrjeve nga Jashtë, në raste të krizës kombëtare si dhe finalizimi i ushtrimit.
Pas përfundimit të ushtrimit të gjithë pjesëtarëve u dhanë certifikata, nga Kolegji Ushtarak i Danimarkës.
Mbështetjen logjistike Njësisë për Reagim të Krizave të FSK-së, i kanë

Ushtrimi është mundësuar nga Qeveria e Danimarkës. Ndërsa mbështetje logjistike i kanë afruar Forcat Daneze të Mbrojtjes, me pajisje dhe mjete të tjera, në terren. Sipas menteruesve danes, ushtrimi u vlerësuar i suksheshëm

afruar Forcat Daneze të Mbrojtjes, me pajisje dhe mjete të tjera, në terren. Ushtrimi u zhvillua në një territor, të gjerë deri 40 km.
Në vjeshtë pritet të realizohet një ushtrim i përbashkët, me ushtrinë daneze dhe të FSK-së, në Kosovë.



Delegacioni i ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë zhvilloi një takim pune në Ministrinë e FSK-së

Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Sllavisha Filipoviqi priti një delegacion të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë i udhëhequr nga kolonel Muhaedin Bela, këshilltar shtetëror për Politika dhe Plane, zonjat Ljubica Pop Taleska, shefe e Seksionit në Departmanetin e Resurseve Humane dhe Julijana Stojanova, nga po ky departament.
Zëvendësministri Filipoviq pasi përshëndeti delegacionit nga Ministria e Mbrojtjes të Maqedonisë u shpreh se shkëmbimi i përvojave në fusha me interes ndërmjet dy ministrive, përkatësisht sektorëve është shumë e dobishme për punën e mëtejshme në planifikim dhe aplikim të politikave të personelit dhe fushave tjera.
Në këtë takim punues nga delegacioni I MFSK-së, morën pjesë: Ismet Mecinaj, shef i Sektorit për Politika të Personeli, Sabri Haxholli, shef i Sektorit për Reklrutim dhe Rezervë, Azemina Qullum , shefe e Zyrës për Komunitete në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, etj.
Në këtë takim pune, temat me interes i prezantuan: shefat e Sektorëve dhe Zyrave të MFSK-së; Ismet Mecianj, temën " Misioni dhe detyrat e ministrisë dhe FSK-së si dhe përgjegjësitë e Departamentit të Personelit", Azemina Qullum prezantoj temën "Përvojat e MFSK-së, në përfshirjen e minoriteteve në MFSK dhe FSK si edhe jetësimi dhe rritja e standardeve dhe të drejtave të punëtorëve". Ndërsa Sabri Haxholli, shef i Sektorit të Rekrutimit dhe Rezervës në MFSK paraqiti temën "Procesi i Rekrutimi të komuniteteve".
Temat e tyre i prezantuan edhe pjesëmarrësit e delegacionit të Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë, si edhe u diskutuan shumë çështje me interes të përbashkët.
Vizita e delegacionit të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë në ministrinë për FSK, u realizua në kuadër të bashkëpunimit shumë mirë që kanë këto dy ministri ndërmjet veti, e cila është e definuar edhe me marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë.

FSK-ja shënon Diten e Tokës

Ministri Agim Çeku dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në kuadër të shënimit të Ditës së tokës, simbolikisht kanë bërë mbjelljen e fidanëve; drunjve dekorativ, pishave, trëndafilave dhe luleve sezonale. Këto mbjellje pjesëtarët e FSK-së i bënë në kazermën "Adem Jashari" të KFT-së, në Prishtinë.



Ministri i FSK-së, Agim Çeku pasi i pari shënoi simbolikisht mbjelljen e fidanëve, tha se mbjellja e drunjve dekorativ dhe fidanëve të tjerë, në kazermat e FSK-së, është një simbolikë, sepse këta drunj do të jetojnë dhe paraqesin një lidhje mes nesh dhe gjeneratave të ardhshme.

"Është obligim i ynë si ministri por edhe si gjeneratë në përgjithësi që gjeneratave që vijnë pas, t'ia lëmë një mjedis jo vetëm të sigurt, por edhe të pastër dhe të favorshëm për të jetuar dhe të punuar" u shpreh ministri Çeku.

Ky aktivitet sot është vetëm një nga mënyrat që ne i përdorim për të krijuar një ambient sa më të mirë për jetë. Dita e tokës është vetëm një ditë, por ne do të kujdesimi për ambientin ku jetojmë dhe punojmë të jetë aktivitet i përbashkët i të gjithë neve.

Në fund ministri Agim Çeku apeloj te të gjithë qytetarët e Kosovës, që të angazhohen maksimalisht për një ambient më të bukur dhe më të pastër në Kosovë, sepse kjo është edhe obligim ligjor e moral, në mënyrë që gjeneratave të reja t'iu sigurojmë ambient të pastër për punë dhe jetë.

Po ashtu pjesëtarët e Batalionit të Tretë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë në qytetin e Mitrovicës së bashku me nxënësit e shkollave të mesme të kësaj komune, mbollën pesë mijë fidanë.

"Në të kaluarën Mitrovica nuk e ka pasur një ambient të pastër, kjo është edhe arsyeja pse sot jemi këtu për të pyllëzuar hapësirat e zhveshura me fidanë pishe, ka thënë zëvendësministri i FSK-së, Shemsi Veseli. Së bashku me Ministrinë e FSK-së në pyllëzim ndihmuan edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, studentët, nxënës të shkollave të mesme dhe shumë pjesëtarë të FSK-së.

Forca e Sigurisë së Kosovës filloi sezonin veror të deminimit

Në ditën ndërkombëtare të vetëdijesimit kundër minave, në Hajvali të Prishtinës, zyrtarisht filloi sezoni veror i çminimit nga Kompania e Deminimit të FSK-së



Në shënimin e fillimit të sezonit veror të çminimit nga njësitet e specializuara të FSK-së, morën pjesë; ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, Gjenerali i KFOR-it, Francesko Diella, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral Gëzim Hazrolli, gjeneralbrigade Imri Ilazi, oficerë të FSK-së, të KFOR-it dhe përfaqësues të medieve.

Me rastin e shënimit të ditës ndërkombëtare të vetëdijesimit nga minat, 4 prill, dhe fillimit të sezonit veror të deminerëve, ministri Agim Çeku duke u uruar fat dhe suksese ekipeve gjatë operimit në terren, pos tjerash tha: "Puna juaj është një punë e dinjitetshme, por edhe me rreziqe të mëdha për jetën tuaj, por, kjo dëshmon gatishmërinë dhe profesionalizimin tuaj, për t'i shërbyer vendit".

Ai ka përmend tri objektivat kryesore të kësaj njësie, të cilat po realizohen me sukses, siç janë: Vetëdijesimi i qytetarëve nga minat dhe nga mjetet e tjera të pashpërthyera, Zbulimi i tyre në terren, si dhe Shkatërrimi i këtyre mjeteve të rrezikshme.

Në Kosovë kanë mbetur shumë fusha të minuara nga forcat serbe, por edhe shumë mjete të pashpërthyera me rastin e bombardimeve nga NATO, mbi caqet serbe. Minat dhe mjetet e pashpërthyera paraqesin ende rrezik të madh për të gjithë qytetarët e Kosovës, kur dihet se në vitin 1999 janë regjistruar 4500 fusha të rrezikshme dhe fatkeqësisht nga këto mina kanë humbur jetën 114 veta, dhe 451 qytetarë kanë mbetur të lënduar, kjo tregon se sa rrezik paraqesin minat dhe mjetet e pashpërthyera. Pjesëtarët e TMK-së e tani pjesëtarët e FSK-së, kanë pastruar mbi 47 milionë metra katror të fushëbetejave dhe kanë pastruar mijëra mina dhe mjete të pashpërthyera, të cilat i kanë asgjësuar me sukses, është kjo, vërtetë, për tu krenuar unë si ministër, komandanti dhe të gjithë pjesëtarë të FSK-së, sepse "minat nuk zgjedhin viktima, por edhe ne nuk zgjedhim se kujt do t'i ndihmojmë, pra jemi në shërbim të gjithë qytetarëve".

"Njësitet tona janë njësi elite në këtë fushë, të trajnuara mirë të pajisura mirë dhe kanë përvojën më të mirë në rajon, Kosova ka kapacitete me aftësi të mëdha, që mund të krenohemi më të, edhe me operacione jashtë vendit, nëse kërkohet nga ne" tha në fund, ministri Çeku.

Për planin dhe angazhimin e Kompanisë së deminimti, të pranishmit i njoftoi komandanti i Kompanisë së Deminimit, major Fadil Sahiti, i cili tha, se këtë vit, do të punohet intensivisht në pastrimin e të gjitha fushave të minuara në Kosovë e në veçanti në Koshare (zonën kufitare), në Kazermën e FSK-së, në Ferizaj, në fshatin Belinc, në Halilaq, etj. Në fund të ftuarit dhe mysafirët e shumtë u njoftuan me pajisjet teknike, me të cilët njësitet e Deminimit punojnë, dhe vizituan disa nga terrenet ku ka filluar çminimi në afërsi të Hajvalisë.

Në ditën e aksionit ta pastrojmë Kosovën

Ministri dhe komandanti i FSK-së, morën pjesë në aksionin, ta pastrojmë Kosovën

Më 24 maj, ministri i FSK-së, Agim Çeku së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandantin e Brigadës së Reagimit të Shpejtë, (BRSH) gjeneralbrigade Nazmi Brahimaj dhe atasheu ushtarak i Ambasadës së Amerikës, në Prishtinë, kolonel Arthur Beauchamp, morën pjesë në aksionin, me moton "Ta pastrojmë Kosovën" në fshatin Dragolevc të komunës së Istogut, në organizim të Zyrës për Komunitete në Ministrinë e FSK-së.

Pjesëtarët e FSK-së, pos aksionit për pastrimin e ambientit të këtij fshati, një ekip mjekësh po kryente edhe aksionin tjetër humanitar, kontrollimin shëndetësor, për banorët e këtij fshati.

Ky është njëheritë fshati i parë i banuar me pjesëtarë të komunitetit serb, që ka filluar ta ketë një bashkëpunim me FSK-në.

Gjatë këtij aksioni, minisitri i FSK-së, Agim Çeku u shpreh se ky fshat është një shembull i mirë i bashkëpunimit me Institucionet e Kosovës. Ai kërkoi nga të gjithë qytetarët e Kosovës, që ky aksion të jetë i vazhdueshëm dhe të shndërrohet në shprehi të përditshme pune, për pastrimin e ambientit tonë.

Atasheu Ushtarak Amerikan, koloneli Arthur Beauchamp, ishte i mahnitur me shembullin e mirë të FSK-së, që po bëjnë në



pastrimin e ambienteve për komunitete, ai i përgëzoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së, dhe tha se ky është një shembull i shkëlqyeshëm i bashkëpunimit të minoriteteve me FSK-në.

Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pos tjerash, tha se; "Ne po punojmë për t'ia përmisuar sado pak kushtet e jetës të gjithë banorëve në Kosovë, por premtoj se edhe në të ardhmen do të angazhohemi aty ku kanë nevojë qytetarët e Kosovës, e jo vetëm në këtë ditë të aksionit. "ne do të angazhohemi me të gjitha forcat dhe mundësit tona, që qytetarëve të Kosovës, t'ia lehtësojmë sado pak kushtet e përgjithshme për jetesë, si në rregullimin e infrastrukturës, etj, që ta kenë një jetë më të mirë"

Në fund, banorët e fshatit Dragolevc, kanë falënderuar FSK-në, për tërë atë që po bëjnë për komunitet në Kosovë.

FSK-ja realizoi edhe një projekt të rëndësishëm në infrastrukturën rrugore në fshatin Turiqicë, të Podujevës

FSK-ja në bashkëpunim me ICITAP-in dhe Komunitetin ka rkryer ndërtimin e rrugës, në gjatësi 5.5 km, nga Orllani deri në fshatin Turiqevc

Forca e Sigurisë së Kosovës ka realizuar dhe po realizon projekte të rëndësishme në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Edhe ky projekt e ka rëndësinë e shumëfishtë për banorët e fshatit Turiqevc. Planifikimin dhe organizimin e ka bërë Departamenti Civilo-Ushtarak i MFSK-së, të cilin e ka ndihmuar ICITAP-i dhe Komuniteti, ndërsa punët; hapjen e trasesë dhe shtrimin me zhavorr të rrugës, në gjatësi mbi 5.5 km. nga fshati Orllan-Turiqevc i ka kryer Batalioni i Xhenios së FSK-së.

Me rastin e përurimit të rrugës u organizuar një ceremoni, ku morën pjesë; ministri dhe komandanti i FSK-së, Agim Çeku e gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zv. ministrat e FSK-së; Shemsi Veseli dhe Bejtush Gashi, oficerë të NAT-it dhe të FSK-së, si dhe banorët e fshatit Turiqicë dhe fshatrave përreth.

Në fjalën e tij, ministri i FSK-së Agim Çeku, ka thënë se FSK-ja, ka kryer vepra të tilla të shumta, gati në të gjitha lokalitet në Kosovë. Edhe kjo punë është një vepër jashtëzakonisht e mirë, sepse tani banorët e kësaj ane e kanë më të lehtë të lidhen me qendrën më të afërt komunale. Ministri premtoi se FSK-ja edhe në të ardhmen do të realizojë projekte të tilla me qëllim që qytetarëve të



Kosovës tu dalë në ndihmë dhe t'ua bëjë lëvizjen e tyre më të lehtë, për t'u lidh me qendrën komunale dhe qendrat e tjera.

Ne, në MFSK dhe FSK rëndësi të veçantë i japim gjithmonë bashkëpunimit civilo-ushtarak dhe projekteve civilo-ushtarake, pasi ky bashkëpunim dhe këto projekte na sjellin më afër qytetareve, na bashkojnë me qytetarët dhe me këto projekte ne i ndihmojmë qytetarët dhe jetën e tyre e bëjmë më të lehtë dhe më të sigurt për qarkullimin e tyre."

Minsitri Çeku ka shprehur emocione të veçanta, gjatë kësaj vizite; "Kam një kënaqësi dhe emocion të veçantë, sa herë që kemi qëndruar në këto treva pranë varrit të heroit tonë, Komandantit Zahir Pajazitit dhe këtyre fshatrave të këtij vendi, që aq shumë i kanë dhënë Kosovës, dhe ndihem mirë që më në fund edhe ne, si FSK, mundem të bëjmë diçka për këta qytetarë, që ta rregullojmë këtë rrugë e cila vërtetë ka qenë e pakalueshme për banorët e kësaj ane.

Ministri i FSK-së Agim Çeku u bëri thirrje të gjithë banorëve të kësaj ane, që të qëndrojnë në tokat e tyre, "Është interes i Kosovës që qytetaret të qëndrojnë në trevat e tyre dhe mos t'i lëshojnë këto fshatra dhe mos të lëvizin drejt qendrave urbane, të qëndrojnë në tokën e tyre

Jemi shumë të lumtur që sot po e inaugurojmë ketë rrugë, sot po ua vëmë në shfrytëzim qytetarëve të kësaj pjese një rrugë e cila vërtetë ka qenë mese e nevojshme.

Gjithmonë edhe si ushtarak ndihemi mirë atëherë kur bëjmë punë të mirë, punë që është në shërbim të qytetarëve dhe punë që ju ndihmon qytetarëve, dhe unë i përgëzoj pjesëtaret e FSK-së, Batalionin e Xhenios, komandantin e FSK-së dhe gjithë ata që kanë kontribuar që sot ne të festojmë për këtë punë të madhe, që FSK-ja, po e bënë në shërbim të vendit tonë, tha në fund ministri Agim Çeku.

Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pasi ka falenderuar Batalionin e Xhenios, për ndërtimin e kësaj rruge dhe projekteve të tjera, ka thënë se:

„Forca e Sigurisë së Kosovës me punë po e dëshmon çdo ditë, që është afër qytetarëve, me realizimin e projekteve të tilla. FSK-ja ka kryer shumë projekte rrugësh, ura dhe projekte të tjera. Komandanti i FSK-së premtoi se FSK-ja edhe në të ardhmen do të jetë gjithmonë aty ku kërkohet nga qytetaret, pa marr parasysh çfarë pune bëjmë: hapje rrugësh, ndërtim urash, ndërtim shtëpish, apo projekte të tjera që janë në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Gjeneral Kastrati falënderoj ECITAP-in dhe Komunitetin; "për mundësinë që na e ka ofruar, përmes sigurimit të derivateve, që FSK-ja, me sukses, ta përfundoj këtë projekt. Për punën dhe angazhimin e Batalionit të Xhenios, të pranishmit i njoftoi komandanti i Batalionit të Xhenios, nënkolonel Zejnë Prokshi. Ai tha se Batalioni i Xhenios, ka kryer një punë vërtetë të dobishme për banorët e këtyre anëve, ata kanë hapur trasenë e rrugës, shtrirjen e zhavorrit, në një gjatësi mbi 5.5 km, për një kohë rekorde.

Në emër të ICITAP-it, Lulzim Fushtica premtoi që edhe në të ardhmen do të punojnë së bashku me FSK-në, në realizimin e projekteve të tilla.

Ndërsa në emër të banorëve të Turiqecit, Nuhi Selimi kryetar i fshatit, ka falënderuar FSK-në dhe ICITAP-in, për ndihmën e madhe që kanë dhënë për banorët e kësaj zone.

Në Prizren Organizata e Personave me Distrofi Muskolare, shënoi javën e saj

FSK-ja ndihmoi personat me distrofi muskulore

Organizata e Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës, (OPDMK) ditë më parë, në qytetin e bukur të Prizrenit, ka shënuar "Javën e distrofisë muskulare", me moton; "Sfida dhe dëshira"

në të cilën aktivitet morën pjesë, mbi pesëdhjetë veta të prekur nga kjo sëmundje.

Shënimin e javës së distrofisë, kësaj organizate ia mundësuan FSK-ja dhe Polica e Kosovës, ku ndihmuan edhe pjesëtarë të KFOR-it, NAT-it, OSBE-së, Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës, CARITAS-it, DOKUFEST-it, etj.

Kryetarja e OPDMK-së, Antigona Shestan, na tha, se: "qëllimi ynë ishte që këtë ditë ta shënojmë më ndryshe; ta vizitojmë Kalanë e qytetit, këmbë.

"Kjo ëndërr do të ishte e parealizueshme për ne, sikur mos të na ndihmonte FSK-ja, ushtarët tanë. Forca jonë na e bëri të lehtë, na e bëri të mundshme dhe të realizueshme, me çka i falënderoj me mijëra herë nga zemra ime", ishin fjalët dhe shprehjet tejet emocionuese të kryetares së OPDMK-së.

Ndërsa në emër të Departamentit Civilo-Ushtarak të MFSK-së, nënkolonel Enver Dugolli, ka thënë: "FSK-ja, gjithmonë është pranë të gjithë qytetarëve të Kosovës, pranë të gjitha kategorive, pa dallime gjinie, race dhe feje, për t'u dalë në ndihmë. Edhe sot, kur jemi së bashku me personat me distrofi muskulare, për këtë, po e ndiejë vetën shumë të relaksuar, sepse shoqëria jonë duhet t'i ndihmojë edhe këtë kategori të qytetarëve tanë, që ata mos ta ndiejnë vetën, se shoqëria po i lenë anash". Ne gjithmonë do tu dalim në ndihmë qytetarëve që e kërkojnë ndihmën tonë", tha në fund nënkolonel Enver Dugolli.





Pasi arritën ta "pushtonin" kalanë, kryetarja Shestan, nga emocionet me lot në sy, na tha:

"Ne kërkuam forca dhe forca jonë na erdhi, pa FSK-në, kurrë nuk do të kishim ardhur këtu, kjo është forca jonë, shumë shumë u jam falënderues".

Ne shumë herë kemi planifikuar ta vizitojmë Kalanë e Prizrenit, jo me automjete, por në një mënyrë krejt tjetër; këmbë, me karroca, për ta shënuar javën e personave me distrofi muskulare, dhe ne menduam që të bëjmë diçka të mirë, për këta persona, që edhe ata ta ndiejnë vetën më afër të tjerëve, më afër shoqërisë; që edhe ne të besojmë se shoqëria jonë është me ne, është afër neve, kjo ëndërr më në fund u realizua falë FSK-së.

Nënkolonel Dugolli dhe ushtarët tanë në çdo moment ishin me ne, na dhanë forcë dhe besim në vete, që sot ta shijojmë ajrin e pastër të Bistricës, të Kalasë sonë, të Prizrenit tonë"!.

Të gjithë personat e ndienin vetëm shumë të relaksuar dhe pothuajse të gjithë kanë shprehur falënderime për ushtarët e FSK-së, të cilët i ndihmuan; duke i bartur në krahë, me karroca dore, etj.

Për herë të parë po e vizitojë Kalanë dhe ndihem shumë e lumtur, këtë ma mundësuan FSK-ja, me çka e falënderojë nga zemra, na tha një vajzë e re, e cila ka mbetur në karrocë, si pasojë e sëmundjes së distrofisë muskulare. Pas vizitës dhe qëndrimit disa orësh në Kala, prapë me ndihmën e ushtarëve të FSK-së, u kthyen në Sheshin e shatërvanit, aty ku filluan garën në maratonë. Si simbolikë të shënimit të javës së personave me aftësi muskulare, ishte bartja me vete e qindra balonave, me ngjyrë të bardhë, simbolik e dashurisë dhe respektit për njeri-tjetrin.

FORCA JONË

∗ ∗ ∗ Viti I • Nr. 2 • Korrik 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës ∗ ∗ ∗



Bruksel

Ministri i FSK-së, Agim Çeku vizitoi Selinë e NATO-s, në Bruksel

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK) Agim Çeku, ka qëndruar në Selinë e NATO-s, në Bruksel, për një vizitë zyrtare i ftuar nga zëvendëssekretari gjeneral ambasadori Alexander Vershbow, në Selinë Qendrore të NATO-s, me të cilin, pati edhe një takim të përbashkët.

Ministri Çeku zhvilloi takime edhe me ambasadorët permanent të vendeve anëtare të NATO-s, në Bruksel.

Gjithashtu, ministri Çeku, realizoi edhe një takim pune, me Frank Bolland, drejtorin e planifikimit të forcës në Drejtorinë e Politikave dhe Planeve të NATO-s, ku e njoftojë atë gjerësisht për të arriturat e FSK-së dhe për planin e zhvillimit të saj.

Në fund të qëndrimit në Bruksel, ministri Agim Çeku pati edhe disa takime të tjera, që janë me interes të veçantë për FSK-në dhe Kosovën.

Intervistë me komandantin e FSK-se, gjenerallejtënant Kadri Kastratin për gazetën e FSK-së, "Forca Jonë"

FSK-ja e gatshme të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe humanitare

"Forca jonë": *Zotëri gjeneral, a mund të na thoni, cilat objektiva i ka përmbush Forca e Sigurisë së Kosovës që nga koha kur e keni marrë detyrën e komandantit të saj?*

Gjeneral Kastrati: Që nga marrja e detyrës së komandantit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, unë i kam shpallur objektivat e mia për FSK-në, për vitin 2012, 2013 dhe 2014. FSK-ja deri me tani i ka përmbushë shumë objektiva. Fillimisht janë aprovuar kapacitet operacionale të rekomanduara nga komandanti i KFOR-it. Unë me stafin tim kemi punuar shumë që FSK-ja të avancohet në fushën e trajnimeve, qofshin ato brenda apo jashtë vendit. Gjithashtu është bërë modernizimi dhe standardizimi i të gjitha pajisjeve dhe legjislacionit, si dhe jemi në rrugë të mirë të standardizimit të rregulloreve për procedurat standarde operative. Kemi hartuar STANAG-un e parë, nivel dhe metodë, për mësimin e gjuhës angleze. Janë realizuar disa operacione dhe trajnime jashtë vendit. Një prej trajnimeve për të cilin unë jam krenar është dërgimi i një togu në Turqi, i cili po përgatitet për pjesëmarrje në operacione paqësore. Po ashtu janë duke u realizuar edhe objektiva të tjerë.

(vijon në faqen 3)



Ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati vizituan ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë

Çeku dhe Kotromanoviç nënshkruan memorandum bashkëpunimi

Një delegacion i lartë nga ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në krye me ministrin Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastratin, zhvilluan vizitë zyrtare në ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë. Delegacioni nga Republika e Kosovës, përkatësisht ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës u prit me nderime të larta shtetërore nga Garda Shtetërore e Kroacisë.

Ministri Agim Çeku dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati me 15 qershor 2012, qëndruan për vizitë zyrtare në ministrinë e Mbrojtjes të Kroacisë, ku u priten nga ministri i Mbrojtjes të Republikës së Krioacisë, Ante Kotromanoviq dhe Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Kroacisë, gjenerallejtënant Drago Lovriq. Delegacioni i ministrisë për FSK-në u prit me nderime më të larta shtetërore, nga Garda Ceremoniale e Ushtrisë së Republikës së Kroacisë.

Gjatë takimit të përbashkët të dyja delegacioneve, ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kroacisë, Ante Kotromanoviq u shpreh shumë i interesuar që të ofroi tërë mbështetjen politike dhe ushtarake për ministrinë dhe FSK-në, në fushën e mbështetjes dhe lobimit në vendet tjera, si edhe mbështetje të pakursyer në trajnime, shkollime dhe specializime të ndryshme për të cilat ka nevojë FSK-ja si një institucion i ri.

Ministri i Mbrojtjes Kotromanoviq siguroi se bashkërisht do të identifikohen fushat në të cilat Ministria e Mbrojtjes së Kroacisë dhe Ushtria e Kroacisë do të mbështesë FSK-në.

Vijon në faqen 2

Admirali Montgomery konfirmon mbështetjen e EUCOM-it

Admirali Mark Mongomery zëvendësdrejtor i Politikave, Planeve dhe Strategjive në Komandën Amerikane për Evropë (EUCOM) me bashkëpunëtorë ka qëndruar për një vizitë pune në Ministrinë e FSK-së, ku ka takuar ministrin Agim Çeku dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me bashkëpunëtorë.

Adrmirali Mantgomery gjatë vizitës ka konfirmuar mbështetjen që EUCOM-i po i jep dhe do t'i jap FSK-së, si në: trajnim, edukim dhe pajisje të FSK-së.



Ministri i FSK-së Agim Çeku, me këtë rast e ka falënderuar admiralin Montgomery dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e vazhdueshme që po i japin FSK-së, dhe e njëherësh e ka njoftuar me zhvillimet e FSK-së, si dhe me rishikimin e Strategjisë së Sektorit të Sigurisë etj.

Çeku dhe Kotromanoviç nënshkruan memorandum bashkëpunimi



Vijon nga faqja 1

Duke e falënderuar për pritjen madhështore, ministri i FSK-së Agim Ceku, e njoftoi ministrin e mbrojtjes së Kroacisë, Kotromanoviq mbi të arriturat e FSK-së deri më tani, si edhe me synimet e saj për të ardhmen duke potencuar se FSK-ja është duke u angazhuar që të marr mbështetje nga Brukseli për Kapacitetet e Plota Operacionale.

Qëllimi i vizitës së krerëve të Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së në Zagreb ishte nënshkrimi i Memorandumit për bashkëpunim ndërmjet të këtyre dy institucioneve, në fushat me interes të përbashkët.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet të dyja ministrive të FSK-së dhe ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, ministrat Çeku dhe Kotromanoviq deklaruan për mediet kroate në Zagreb, së kjo ditë shënon një fillim të ri të marrëdhënieve të ngushta ndërmjet të këtyre dy institucioneve, dhe se bashkëpunimi do të intensifikohet në të ardhmen dhe për ketë u shprehen të gatshëm të dy ministrat.



Delegacioni nga Ministria e FSK-së, i udhëhequr nga ministri Ceku, vizitoi edhe Bazën e Trajnimit për Operacione Ndërkombëtare në Rakitje, pastaj Qendrën Operative të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë.

Në vizitë në ministrinë e Mbrojtjes të Kroacisë nga pala e Kosovës morën pjesë pos ministrit Çeku dhe KOMFSK, gjeneral Kastrati, edhe zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ambasadori i Republikës së Kosovës në Kroaci, Valdet Sadiku , drejtori i drejtorisë për Politika dhe Plane në MFSK, Haxhi Shala, drejtori i departamentit Bashkëpunim dhe Siguri, kolonel Ilir Qeriqi si edhe zyrtari i lartë për Bashkëpunim dhe Siguri Mark Shala.

Ministri i FSK-së Agim Çeku është takuar me Komitetet Ushtarake të NATO-s dhe BE-s

Me rastin e vizitës së Komiteteve Ushtarake të NATO-s dhe BE-së në KFOR, Ministri Agim Çeku është ftuar që të njoftojë rreth situatës aktuale në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Gjatë njoftimit nga ana e tij, Ministri Çeku ka informuar rreth të arriturave në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ministri Agim Çeku ka çmuar bashkëpunimin me NATO-n dhe ka shprehur pritjet e tija që Kapacitetet e Plota Operacionale për Forcën e Sigurisë së Kosovës të miratohen nga NATO-ja sa më shpejtë që është e mundur.

Gjithashtu, ministri Çeku ka theksuar gatishmërinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës për të marrë pjesë në operacionet paqësore kudo që është e nevojshme dhe se i ka informuar ata rreth vizionit dhe së ardhmes së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

90 oficerë të FSK-së kthehen nga trajnimi në Gjermani me rezultate të shkëlqyeshme

Pas një trajnimi tre-javor në Akademinë e Nënoficerëve në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimeve në Grafenworh të Ushtrisë Amerikane, në Gjermani, janë kthyer nëntëdhjetë nënoficerë të FSK-së, të cilët kanë treguar rezultate të shkëlqyeshme.

Ky trajnim është shumë i rëndësishëm për FSK-në, sepse vlerësimet e këtij trajnimi janë mbi 30% të tejkalimit të standardeve që ka parashikuar NATO për FSK-në.

Në ceremoninë e organizuar për pritjen e nënoficerëve të FSK-së, në kazermën "Adem Jashari" në KFT, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, që në fillim ka shprehur falënderime të veçanta për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermaninë, të cilat po ndihmojnë vazhdimisht me trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së. Ai u shprehë se ndjehet tejet i lumtur për trajnimin e nënoficerëve që është baza kryesore e çdo ushtrie.

"Ky është një trajnim shumë i rëndësishëm për FSK-në e që është edhe një prej objektivave për ngritjen e strukturës së nënoficerëve. Duke u mbështetur në atë objektiv, ne kemi arritur t'i kryejmë shumë trajnime të nënoficerëve.

"Unë si komandant i FSK-së jam shumë i lumtur dhe krenar, që nënoficerët e FSK-së, kanë treguar një performancë të mirë, kanë prezantuar FSK-në ashtu siç ne synojmë. Synimi ynë është që ta bëjmë një forcë ushtarake, ta bëjmë një forcë e cila do të jetë krah për krah me të gjitha ushtritë, në radhë të parë të rajonit dhe më gjerë, në ngritjen e kapaciteteve me standarde të NATO-s. Kjo tregon që FSK-ja është shumë aktive dhe është duke ecur drejt ngritjes së profesionalizmit dhe drejt shndërrimit në një forcë që i nevojitet Republikës së Kosovës, Shpresojmë që shumë shpejt të mund të japim kontribut tonë edhe jashtë Kosovës, në misione paqeruajtëse dhe humanitare. Të gjitha raportet që i kemi marrë nga Akademia, kanë qenë të mrekullueshme dhe kjo na bënë neve të lumtur jo vetëm mua si komandant por edhe stafin komandues të FSK-së.

"FSK-ja për tri vite ka ecur me hapa të shpejtë, është pasuruar me njohuri të ngritjes profesionale në të gjitha fushat .

Ky trajnim është me rëndësi të madhe për FSK-në, sepse ne vetëm me ndërtimin e korit të nënoficerëve e ndërtojmë edhe ushtrinë. Pjesëtarët e FSK-së i kanë kaluar të gjitha trajnimet që i kryejnë edhe ushtritë e tjera të NATO-s dhe FSK-ja ka treguar rezultate të standardeve më të larta të shteteve të NATO-s.

"Lirisht themi se mund të krahasomi edhe me të gjitha ushtritë e NATO-s Për këtë, ne, po punojmë vazhdimisht, që vetëm me këtë nivel, të anëtarësohemi në NATO".

Në fund komandanti i FSK-së, falënderoi nënoficerët e FSK-së, për performancën, disiplinën dhe profesionalizmin që kanë treguar gjatë trajnimit dhe premtoi se nënoficerëve më të dalluar, do tu jap mirënjohje dhe dekorata për suksesin e treguar në Akademinë Ushtarake në Gjermani.

Letra e admiralit Mark C. Montgomery dërguar ministrit Çeku

Komanda e Shteteve të Bashkuara për Evropë
Njësia 30400
APO AE 09131


ECJ5/8
21 qershor, 2012

I nderuari Ministër Çeku,
Në emër të Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara, juve dhe pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës ju përgëzoj për performancën e nëntëdhjetë pjesëtarëve të FSK-së, në Kursin e Liderëve të Luftëtarëve në Akademinë e Shtatë të Nënoficerëve.
Ju kemi bashkangjitur një prezantim të vogël në Power Point si shembull të performacës së shkëlqyer të personelit tuaj. Komenti më i mirë të cilin e kam dëgjuar është komenti të cilin e kam marr dje me postë elektronike nga një Nënoficer i lartë i yni:
"Më duhet të them se këta studentë me të vërtetë ndryshojnë nga normat, kur bëhet fjalë për këto lloj trajnimesh. Ata i kanë kaluar pengesat për gjysmën e kohës të së cilës ushtarëve Amerikan ju duhet dhe me teknika tjera të cilat asnjeri nga ne nuk i kemi parë më herët..."

SFC Antwan Garner, SHBA
Ky është një testament personelin madhështor të cilin ju e keni në dispozicion, dhe pres me padurim që të shoh më shumë performanca nga ekipi të cilin ju jeni duke e ndërtuar!
Po ashtu, Shefi kryesor i Flotës, oficeri i ri Roy Maddocks planifikon të merr pjesë në diplomimin e tyre, dhe jam i sigurt që ai do ta përcjellë respektim dhe vlerësimin tonë direkt te studentët.

Bravo Zulu!

Me respekt,
MARK C. MONTGOMERY
Kundër Admiral, USN
Zëvendës Drejtor për Plane, Politika dhe Strategji



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

FSK-ja e gatshme të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe humanitare

(Vijon nga faqja 1)



"Forca jonë": *Sa ka arrit FSK-ja t'i përmbush standardet që kërkohen nga NATO?*
Gjeneral Kastrati: FSK -ja ditaditës është duke i përmbushur standardet e NATO-s. Duke filluar që nga trajnimet dhe pajisjet, qofshin ato individuale apo kolektive, pastaj legjislacioni dhe dokumentet tjera që prodhon FSK-ja, që të gjitha janë në përputhje me standardet e NATO-s.

"Forca jonë": *FSK-ja gjatë pjesëmarrjes së saj, në shumë trajnime dhe operacione jashtë vendit, ka treguar një paraqitje të jashtëzakonshme, cilat janë rezultatet konkrete?*
Gjeneral Kastrati: Ne, vazhdimisht, marrim lëvdata të shumta për pjesëtarët tanë të cilët marrin pjesë në trajnime dhe operacione jashtë vendit, qoftë si individ, qoftë në mënyrë kolektive. Vlen të përmendet suksesi i 87 nënoficerëve, të cilët i kemi dërguar në Gjermani, në Akademinë e Nënoficerëve të SHBA-s, ku kanë treguar arritje të jashtëzakonshme. Për këtë sukses, vetë admirali Mongomeri i ka dërguar një letër ministrit Çeku, ku e ka falënderuar për angazhimin e madh që kanë treguar pjesëtarët e FSK-së. Po citoj një fjali ku thotë" Shumica e nënoficerëve dhe ushtarëve amerikan, gjatë këtij lloj trajnimi, nuk mund të arrijnë as 50% të rezultateve që i kanë arrit nënoficerët e FSK-së." Besoj kjo flet mjaft për rezultatet në ngritjen profesionale të FSK-së.

"Forca jonë": *Pas tërë këtyre të arriturave në aspektin profesional a është FSK-ja e gatshme që të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse, në Botë?*
Gjeneral Kastrati: Forca e Sigurisë së Kosovës, qysh nga dërgimin e një togu në Turqi, muaj më parë, që është përgatitur dhe certifikuar për operacione paqësore dhe humanitare nëpër botë, është e gatshme kurdo që kërkohet nga NATO-ja, Kombet e Bashkuara apo Bashkimi Evropian, që të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe humanitare. Jemi të gatshëm që në kuadër të ndonjë shteti apo kontingjenti të marrim pjesë në operacione të kërkim-shpëtimit, deminimit, mjekësisë, logjistikës dhe të xhenios..

"Forca jonë": *Zotëri gjeneral, si është trajtimi i FSK-së gjatë pjesëmarrjes së saj në operacione, siç ishte rasti i fundit, në Krivollak të Maqedonisë, ku morën pjesë së bashku me ushtritë e rajonit?*
Gjeneral Kastrati: Në rend të parë i falënderoj dhe i përgëzoj të gjithë kadetët, nënoficerët dhe oficerët që kanë marrë pjesë në këtë ushtrim dhe e kanë prezantuar Forcën e Sigurisë së Kosovës në mënyrën më të mirë. Pjesëtarët e FSK-së janë dalluar si pjesëmarrës shumë të mirë, në këtë ushtrim. Dhe këtu kanë treguar një paraqitje qoftë kolektive apo individuale si njësit i FSK-së, krah për krah me të gjitha ato shtete që kanë marrë pjesë, që nga Britania e Madhe, Bullgaria, Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria etj. Kanë treguar se FSK-ja është e gatshme dhe e barabartë me të gjitha këto ushtri që kanë marrë pjesë në këtë operacion. Dhe, kjo na gëzon që FSK-ja është trajtuar si ushtri, si organizatë e barabartë me të gjitha këto shtete, duke treguar profesionalizëm në ballafaqimin me të gjitha sfidat, gjatë këtyre ditëve sa kanë qëndruar atje.

"Forca jonë": *Zotëri gjeneral, dihet tashmë se FSK-ja ka një bashkëpunim të mirë, në rajon dhe botë, cilat janë këto relacione e veçanërisht bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të IOVA-s-SHBA-s?*
Gjeneral Kastrati: Në nivel të rajonit, përveç me Serbinë, ne, kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Malin e Zi , Shqipërinë dhe Maqedoninë. Tashmë kemi filluar të marrim pjesë edhe në operacione dhe ushtrime të përbashkëta, si këtë vit në Krivollak. Për vitin e ardhshëm është planifikuar një ushtrim i përbashkët në Shqipëri, ku do të marrin pjesë shumë shtete dhe më këtë rast FSK-ja do ta arrijë edhe një prej objektivave të saj, bashkëpunimin me shtetet e rajonit. Ne, bashkë me Gardën Kombëtare jemi duke e zbatuar atë program në përgjithësi. Një ekip i yni, ka qëndruar për një kohë në Gardën Kombëtare të Shtetit të IAWS, ku është zhvilluar një ushtrim i madh i përbërë nga tri shtete. Pjesëtarët tanë aty kanë marrë eksperiencë dhe shumë njohuri nga mobilizimi, planifikimi dhe ekzekutimi i ushtrimeve, ku pas kthimit në Kosovë, kanë përpiluar një raport të përgjithshëm me njohuri të reja. Gjithashtu, ne kemi edhe programe të reja me Gardën Kombëtare të Shtetit të AIWS , të cilat jemi duke i përmbushur së bashku . Planifikojmë ta rrisim bashkëpunimin për trajnime më të avancuara, jo vetëm të nënoficerëve por edhe të pilotëve dhe ekipeve të tjera të specializuara, të cilët në të ardhmen do t'i nevojitet shumë vendit tonë për kryerjen e detyrave sipas misionit.

"Forca jonë": *FSK-së i duhet edhe kuadri profesional, çfarë po bën në këtë drejtim?*
Gjeneral Kastrati: Profesionalizmi është një aktivitet i përhershëm. Ai është edhe objektiv i imi primar. Në rend të parë do ta kem për bazë profesionalizimin dhe trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së. Edhe këtë vit, do të vazhdojmë me rekrutimin e gjeneratës së re të kadetëve. Konkursi për vitin e ri akademik 2012-2013 veç është hapur, unë shpresoj sikur se edhe vitin e kaluar do të kemi shumë të rinj të interesuar për të qenë kadet. Kadetët do të studiojnë në Universitetin Amerikan, kurse në QSU të FSK-së do të mbahen sipas standardeve të NATO-s.

"Forca jonë": *Çka pas përmbushjes së atributeve të FSK-së, cili do të jetë finalizimi i saj?*
Gjeneral Kastrati: Ne këtë vit duhet të vazhdojmë me ngritjen e kapaciteteve tona operacionale, me profesionalizimin e forcës, me trajnimet të cilat i kemi sipas programit dhe duhet të vazhdojmë t'i kryejmë të gjitha detyrat tjera qofshin ato operacionale apo humanitare, siç janë: kërkim-shpëtimi, çminimi, mbrojtja kimiko-atomike-biologjike etj., ku ne jemi duke dhënë një kontribut të madh në ngritjen e modernizimit të Forcës. Në ngritjen e nivelit të gatishmërisë për t'i kryer të gjitha detyrat sipas misionit dhe detyrat qe na dalin nga ky mision. Gjithashtu jemi duke bërë edhe rishikimin e Strategjisë së Sektorit të Sigurisë në nivel të shtetit. Ne si FSK jemi duke e rishikuar strukturën e tanishme dhe misionin e FSK -së për avancimin e saj në të ardhmen. Mirëpo deri në marrjen e rekomandimeve nga grupet punuese, grupet e ekspertëve në bashkëpunim me miqtë tanë ndërkombëtarë , ne do të vazhdojmë misionin të cilin e kemi aktualisht dhe të përgatitemi për të ardhmen.

Kadetët e Forcës së Sigurisë së Kosovës morën pjesë në stërvitjen ushtarake "Kampi veror 2012" në Krivollak të Maqedonisë

Ministri dhe komandanti i FSK-së përcollën nga afër operacionin përfundimtar ushtarak të kadetëve të FSK-së, në Krivollak të Maqedonisë



Kadetët e Forcës së Sigurisë të Kosovës për herë të dytë morën pjesë në "Kampin verorë 2012" , përkrah kadetëve të ushtrive të vendeve, si; Britania e Madhe, Bullgaria, Turqia, Mali i Zi dhe Maqedonia. Kadetët e FSK-së, në Kampin ushtarak në Krivollak kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme, si në nivelin ekipor dhe atë individual.

Me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, një njësitë i kadetëve të FSK-së, për dy javë, mori pjesë një në Ushtrimin fushor Ndërkombëtar "Kampi veror 2012" në Poligonin ushtarak, në Krivollak, të Maqedonisë.

Ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me Ministrin e Mbrojtjes të Maqedonisë, z. Fatmir Besimi dhe ushtarakë të tjerë të ushtrive të vendeve pjesëmarrëse, përcollën nga afër ushtrimin e përbashkët përfundimtarë të kadetëve, në bazën ushtarake të Krivolakut më 28 qershor 2012.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku me këtë rast vlerësoi lart ushtrimin e përbashkët të kadetëve, duke qenë se kadetët e FSK-së, edhe pse po marrin pjesë për herë të dytë në Krivollak, treguan paraqitje të shkëlqyeshme, në mesin e kadetëve të shteteve të rajonit. Kjo është një ngjarje jashtëzakonisht e rëndësishme për FSK-në, për arsye se, për herë të dytë, njësiti i FSK-së, po merr pjesë në Qendrën për Trajnime në Krivollak të Maqedonisë, dhe kjo na gëzon edhe më shumë për arsye se për herë të dytë FSK-ja ka mundësi që me këtë njësit të tregojë se është një forcë profesionale dhe e cila mund të krahasohet dhe të jetë përkrahë me të gjitha ushtritë e rajonit dhe ushtritë e NATO-s.

Ministri Çeku tha, se:"FSK-ja është duke u zhvilluar dhe trajnuar në bazë të standardeve të NATO-s dhe në partneritet dhe bashkëpunim me vendet e rajonit, të SHBA-së, dhe vetë pjesëmarrja e FSK-së, kontribuon në sigurinë rajonale dhe me gjerë. Ndërsa Ministri i Mbrojtjes së Maqedonisë Fatmir Besimi po ashtu e vlerësoj si të arritur bashkëpunimin ndërmjet ushtrive të vendeve të rajonit në realizimin e ushtrimeve të përbashkëta ushtarake, në të cilat ushtrime, kadetët e rinj, të vendeve të ndryshme vepruan si një trup, si një njësit i vetëm.

Po ashtu edhe ministri i Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Fatmir Besimi tha se performanca e të gjithë kadetëve gjatë demonstrimit ishte në nivel të lartë dhe se ai përgëzoi posaçërisht Forcën e Sigurisë së Kosovës e cila po ecën me hap të sigurt drejt arritjes së standardeve të kërkuara.

Në këtë ushtrim pos kadetëve nga Kosova, morën pjesë edhe kadetët, nga: Britania e Madhe, Bullgaria, Mali i Zi, Maqedonia dhe Turqia, me të njëjtin numër të pjesëmarrësve. Këto ushtrime kanë për qellim përgatitjen për operacione të paqes, si edhe veprimin si një trup të ushtarakëve të vendeve të rajonit, në raste të misioneve kudo dhe kur do që kërkohet të angazhohen, duke zbatuar të njëjtën doktrinë, atë të NATO-s.

Pjesëmarrja e kadetëve të FSK-së, në ushtrime rajonale është dëshmi se FSK-ja, po arrin me sukses plotësimin e kapaciteteve dhe kritereve me standarde më larta të shteteve anëtare të NATO-s.

Pos ministrit Agim Çeku, komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastratit, në Krivollak ishin edhe gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, ambasadori i Republikës së Kosovës në Maqedoni, Ylber Hysa, shefi i Këshilltarëve të NATO-s, për FSK-në, Kevin Linç, etj.

Kadetët e FSK-së, në Kampin ushtarak në Krivollak të Maqedonisë, kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme si në nivelin ekipor dhe atë individual. Operacioni ka përfunduar pas dy jave, me shpalljen e rezultateve të ushtrimeve. Ky është edhe një sukses i merituar i kadetëve të FSK-së, në nivelin rajonal.







Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj

Diplomoi gjenerata e katërt e kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, me një ceremoni solemne ditë më parë diplomoi gjenerata 2012-të e kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare (QSU) të (FSK).
Diplomuan dhe u graduan këta kadetë: **Manushaqe Nura, Afrim Xhelili, Mimoza Budeci, Albert Asllani, Krenar Lahu, Besnik Thaçi, Bujar Ferizi, Drilon Llalloshi dhe Nysret Buzhala**



Ministri i FSK-së, Agim Çeku, ju drejtua kadetëve me këto fjalë: "Të nderuar kadet-faleminderit për këtë pamje kaq të bukur që na dhuruat e cila na bënë të gjithë neve të ndihemi krenarë me ju dhe që nga sot, ju po e fuqizoni FSK-në, po filloni t'i shërbeni vendit dhe popullit tuaj. Kjo ceremoni të nxitë ndjenja të veçanta kur FSK-ja po rritet, po fuqizohet dhe që nga sot, po i shtohen edhe këta oficerë të rinj, të shkolluar, të edukuar dhe të trajnuar sipas standardeve më të larta të NATO-s".
Ministri Çeku, më tej vazhdoi: "Të nderuar kadetë, sot ju po bëheni oficere të FSK-së, oficerë të Kosovës, si ministër i juaj sot dhe ish ushtarak i karrierës e shoh të udhës që të ju jap disa këshilla, të cilat i kam sprovuar gjatë karrierës sime ushtarake.
Këshilla e parë; udhëhiqni dhe komandoni me shembullin tuaj. Ushtarët tuaj do të ju vlerësojnë. Çka do që ju bëni do të vlerësohet, do të matet dhe do të komentohet nga varësit e juaj. Nëse ju jeni të vendosur, të guximshëm dhe të palëkundur në realizimin e detyrave edhe ushtarët e juaj do të jenë të tillë. Po nëse ju ligështoheni, dorëzoheni para vështirësive dhe sfidave edhe ata do të bëjnë të njëjtën gjë.
E dyta; Dëgjoni dhe mësoni: Mos harroni se shumë nga eprorët, bashkëpunëtorët, por edhe vartësit tuaj, sidomos ata më të moshuar se ju dhe nënoficerët e juaj kanë një përvojë dhe kanë shumë për t' ju këshilluar dhe mësuar juve. Mos mendoni se i dini të gjitha, dëgjoni dhe mësoni nga ta, kjo gjë, do t' ju shpaguhet.
E treta; Merrni vendime: Pasi të dëgjoni mendimet dhe këshillat e vartësve tuaj, ju duhet të merrni vendim. Do të këtë shumë momente kur sytë e të gjithëve do të jenë të drejtuar kah ju. Duhet të jeni të gatshëm edhe për vendime të vështira.
E katërta; Udhëhiqni gjithmonë duke qëndruar në ballë: Në çdo veprim të njësitit tuaj, ju duhet të jeni të dukshëm dhe të udhëhiqni vallen. Ju duhet të keni aftësi fizike, aftësi profesionale dhe kredibilitet personal për t'i frymëzuar ata që udhëhiqni. Mos harroni se është e pamundur të udhëhiqni nga vendi i fundit i rreshtit.
E pesta; Mbani ushtarët e juaj të informuar: Secili nga varësit tuaj, duhet ta dinë, se si, por edhe pse. Nëse ju, ua shpjegoni rëndësinë e asaj që ata duhet të bëjnë, ata do ta zbatojnë misionin dhe E gjashta; Udhëhiqni dhe ndërtoni ekipin e juaj. Mbani në mend se e tëra ka të bëjë me ekipin. Deri tani ju jeni vlerësuar si individ, se sa i mirë ke qenë në shkollë. Nga tani, ju gjithmonë do të vlerësoheni se sa i mirë është njësiti juaj. Mos harroni, nuk mund të ketë komandant togu të mirë, në një tog të dobët.
Në fund ministri Çeku u tha kadetëve të sapodiplomuar: "Ju gjatë karrierës suaj, do të përballeni me detyra të vështira, sfida të mëdha, sakrifica, madje edhe dhimbje të mëdha. Megjithatë ndjenja e krenarisë pas kryerjes së misionit dhe detyrave, ndjenja e shërbimit ndaj vendit dhe popullit, respekti dhe besimi i vartësve tuaj ndaj jush do t'ua mbulojë të gjitha vështirësitë, sakrificat, por ndoshta, edhe humbjet që ju i keni bërë gjatë kryerjes së misionit.
Jam shumë i sigurt se ju do t'i përmbushni pritjet tona.

Në fjalën e tij komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pasi përshëndeti të pranishmit, tha: "Të nderuar kadet të FSK-së, diplomimi dhe gradimi juaj edhe për FSK-në dhe për mua është një ditë e veçantë, një ngjarje e veçantë që më bënë të ndihem krenar si komandant i FSK-së. Dita e gradimit të sotëm e kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së në gradën e nëntogerit, është dita e kurorëzimit të një pune të gjatë, këmbëngulëse, me shumë privacione për ju si moshë e re, të cilët nga jeta civile veshët uniformën dhe ju nënshtruat jetës ushtarake, ku studimi, puna, përkushtimi, rendi dhe disiplina zbatohen në shkallë më të lartë.
Diplomimi dhe gradimi i kadetëve është një shembull i qartë i zhvillimit dhe i progresit përmes investimit në dije dhe në shkencë, që po e krijon Forca e Sigurisë së Kosovës në ngritjen, profesionalizimin e saj, si investimi më i mirë për të ardhmen. Kjo po dëshmon më së miri, se ne po e krijojmë një forcë profesionale dhe me standardet më të larta, të NATO-s. Me këto standarde ne mund të jemi pjesë e NATO-s dhe mund të ndihmojmë në misionet e sigurisë kolektive edhe jashtë vendit, për të mirën e rajonit dhe më gjerë".
Gjeneral Kastrati më tej ju drejtua oficerëve të sapodiplomuar: "Oficerë të rinj të FSK-së, Ju e arritët këtë nivel në gradën e nëntogerit, dhe unë ju përgëzojë për suksesin e arritur. Por rruga e juaj e nxënies së njohurive nuk mbaron me kaq, ju duhet të vazhdoni rrugëtimin tuaj për përsosje profesionale. Mësimet tuaja teorike t'i zbatoni me sukses në praktikë, në njësit ku do të emëroi në detyrë. Të punoni dhe drejtoni me moton e njohur për çdo ushtarak: Nderi - Detyra - Atdheu është mbi të gjitha. Unë shpreh bindjen e thellë se zelli, disiplina dhe motivimi, që ju ka përcjellë deri sot, për t'u përgatitur që të ballafaqoheni me situata komplekse të cilat do të jenë pjesë e misioneve tona brenda dhe jashtë vendit, do të vazhdojnë të jenë udhërrëfyesi juaj në këtë rrugëtim të cilin do ta ndërmarrim së bashku. Ju duhet të jeni shembulli më i mirë se si duhet punuar dhe zhvilluar mbi baza dhe standarde profesionale".
Në ceremoninë e diplomimit-gradimit merrnin pjesë; ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajori Erhard Drews, zëvendës komandanti i Komandës së Forcës Tokësore, gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për mbikëqyrje të FSK-së, oficerë të lartë të FSK-së dhe të KFOR-it, familjarë të kadetëve dhe qytetarë të shumtë.
Diplomat për gradimin e kadetëve i dhanë; ministri i FSK-së, Agim Çeku, KOMKFOR-it, Erhard Drews dhe KOM i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati

Gjeneral Drews: Ju e keni zgjidhur një rrugë të shenjt për t'i shërbyer Kosovës

"Për më tepër se tri vite KFOR-i dhe kombet të cilat e përbëjnë KFOR-in, kanë punuar si partner me Kosovën për të ndërtuar një Forcë të Sigurisë Profesionale dhe që po dëshmohet edhe me këta oficerë, që po i shihni, me paraqitjen e tyre sot. Ju po bëheni oficerë të Sigurisë së Kosovës, por, për ma tepër ju po bëheni udhëheqës. Ju e keni zgjidhur një rrugë të shenjt për t'i shërbyer Kosovës dhe ajo se si do ta drejtoni nga sot dhe tutje do të vendos se çfarë oficeri do të bëheni në të ardhmen. Jam i sigurt se keni marrë mësime të shumta sa i përket lidershipit dhe ju duhet të bëheni lider të mirë, përfshirë këtu:integritetin, besimin, respektin, etj. Të qenët



udhëheqës nuk është shpesh e lehtë, shpesh duhet të marrin vendime të cilat nuk janë të lehta. Mirëpo si lider ju më përvojën tuaj dhe me informatat të cilat ju do t'i keni në dispozicion do të mësoni se si, t'i merrni vendimet më të mira në kohën e duhur. Më pas do të kuptoni se a keni marrë vendimin e duhur në të kaluarën dhe vetëm në këtë mënyrë ju do të avanconi dhe do të bëni përvojë. Ju do t'i vendosni standardet që t'i përcjellin të tjerët, vendosni ato të larta.
Si oficerë dhe si udhëheqës ju çdo herë duhet të jeni të dukshëm dhe çdo herë duhet të priten shembuj të mirë nga ju. Kjo është për arsye se çka do që do të bëni ju, do të ndikojë në kualitetin e organizatës tuaj dhe përfundimisht në repucionin e Kosovës. Motoja juaj nuk duhet të jetë ndryshe nga çfarë do organizate tjetër kualitative, siç janë: Detyra, Nderi dhe Atdheu
Ju jeni forcë e rëndësishme për Kosovën dhe juve ju është dhënë një përgjegjësi mjaft e madhe, si oficerë të FSK-së, ju do ta luani një rol mjaftë të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejmë të kësaj force dhe ta bëni Kosovën më të mirë. Ju uroj diplomim tuaj dhe ju uroj çdo të mirë si oficerë të rinj.

Një delegacion i Forcave Ajrore të Shqipërisë vizitoi FSK-në



Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati ka pritë delegacionin e Forcave Ajrore të Republikës së Shqipërisë, (FARSH) të udhëhequr nga komandanti i saj, gjeneralbrigade Dhori Spirollari, me bashkëpunëtorë, të cilët kanë qëndruar për një vizitë pune, treditore, në FSK.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati u ka dëshiruar mirëseardhje oficerëve të FA-së, dhe njëherësh i ka njoftuar për të arriturat e FSK-së, plotësimin e Kapaciteteve Opracionale, trajnimet, shkollimin dhe zhvillimet e tjera të FSK-së.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, delegacioni i Forcave Ajrore të Shqipërisë ka vizituar Komandën e Forcave Tokësore të FSK-së, ku është pritë nga shefi i Shtabit të KFT-së kolonel Naim Haziri i cili e ka njoftuar komandantin e FARSH-së, gjenerlbrigade Dhori Spirollarin me zhvillimin e Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së dhe njësive të saj.

Delegacioni i FA-së, në ditën e fundit të qëndrimit në Kosovë, ka vizituar Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, në KFT dhe Komandën e Doktrinës e Stërvitjes, në Ferizaj. Delegacionin, me punën e QSU-së i ka njoftuar komandanti i saj, major Haki Xhemajli, ndërsa për punën dhe të arriturat e KDS-së, i ka njoftuar, zëvendës komandantja Irfete Spahiu, kolonele.

Në fund, në emër të delegacionit ka falënderuar komandanti i FARSH-së, gjeneralbrigade Dhori Spirollari i cili konfirmoi edhe njëherë mbështetjen e vazhdueshme për Forcën e Sigurisë të Kosovës.

Projekte humanitare

Përurohet Qendra e Përkujdesjes ndaj Nënës dhe Fëmijëve, projekt i përbashkët i SHBA-ve dhe FSK-së

Michael Murphy;" Kjo qendër u ofron strehim grave dhe fëmijëve jetim dhe ne pasi kemi pas mundësi të ndihmojmë financiarisht jemi bërë bashkë me FSK-në. Kjo tregon se FSK-ja çdo herë e më shumë po arrin të përmirësohet dhe të arrij kapacitetet e saj dhe të bëhet forcë moderne e sigurisë!



Meremetimi i Qendrës së Përkujdesjes ndaj Nënës dhe Fëmijëve në Prishtinë, është projekt i përbashkët i realizuar me Zyrën për Bashkëpunim të Mbrojtjes të SHBA-ve, i ndihmuar nga populli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet partneritetit të Komandës për Evropë të Ushtrisë Amerikane, dhe i realizuar përmes departamentit të BCU-së, të FSK-së. I ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA-ve, në Prishtinë, z. Michael Murphy, me rastin e përurimit të kësaj qendre për përkujdesjen e nënës dhe fëmijëve, tha: " Është kënaqësi që jam sot këtu, të inaugurojmë dhe kremtojmë për këtë partneritet publiko-privat, mes këtij institucioni dhe FSK-së dhe po ashtu edhe partneritetit mes SHBA-s dhe Kosovës. FKS-ja së bashku me një organizatë lokale kanë identifikuar këtë lokacion i cili ka nevojë për renovim, kjo është një qendër që u ofron strehim grave dhe fëmijëve jetim dhe ne pasi kemi pas mundësi të ndihmojmë financiarisht jemi bërë bashkë me FSK-në dhe kemi punuar në drejtim që të përfundoj kjo punë. Ky bashkëpunim demonstron, tri gjera:


E para: Partneritet mes SHBA-ve dhe Kosovës.

E dyta: tregon se FSK-ja çdo herë e më shumë po arrin të përmirësohet dhe të arrij kapacitetet e saj dhe të bëhet forcë moderne e sigurisë, sepse operacionet humanitare janë pjesë e forcave të mbrojtjes kudo, departamenti ynë i Mbrojtjes e bën këtë shumë shpesh, dhe

E treta: më e rëndësishmja tregon përkushtimin e FSK-së dhe SHA-ve për të ndihmuar këtë pjesë të popullatës që është më e lëndueshme, siç janë edhe njerëzit që e përdorin këtë objekt.

SHBA-ja përmes projekteve të ndryshme ka ndihmuar edhe në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, por edhe çështje tjera sociale, kësisoj vitin e kaluar përmes një projekti zyra e SHBA ve ka bërë ndërtimin e ndërtesës për gratë lehona të komunitet Goran, në rrethinë të Prizrenit.

Ndërsa zëvendësministri i FSK-së, Shemsi Veseli në emër të Ministrisë së FSK-së e ka falënderuar Ambasadën amerikane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për ndihmat që po japin për Kosovën dhe FSK-në. "Kjo ndihmë është e mirëseardhur, sepse edhe këta janë pjesë e shoqërisë sonë, të cilët duhet ta ndiejnë vetën si pjesë normale e shoqërisë dhe ata duhet të integrohet sa më mirë. Kjo qendër ka dhënë një kontribut edhe gjatë luftës, falë veprimtares së njohur, doktoreshës Flora Brovina e cila ka ndihmuar shumë në strehimin e fëmijëve gjatë luftës, dhe pas luftës në edukimin e shumë fëmijëve bonjakë. Falë këtij donacioni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, FSK-ja e ka dhënë kontributin e vet në meremetimin e kësaj qendre, për përkujdesjen e nënës dhe fëmijëve. Dhe, kjo punë e përbashkët dëshmon partneritetin e fuqishëm që kemi në mes dy shteteve tona, dhe ju premtoj; se ne do të jemi çdo herë të gatshëm që edhe më tej t'i ndihmojmë të gjithë qytetarët e Kosovës", tha në fund, të fjalës së tij, zëvendës ministri i FSK-së, z. Veseli.



Njësiti i Xhenios të FSK-së, për renovimin e qendrës, ka kryer mbi 700 orë pune. Në përurimin e Qendrës për Përkujdesjen e Nënës dhe Fëmijëve, në Prishtinë, morën pjesë edhe; sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Syla, drejtori i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjenerelbrigade Zymer Halimi, atasheu ushtarak i Mbrojtjes në Ambasadën Amerikane, koloneli Arthur Beauchamp, oficerë të FSK-së, etj.

Në fund në emër të Flora Brovinës, drejtoreshës së kësaj qendre, ka falënderuar të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Amerikës, në Prishtinë, Halime Maliqi. Me këtë rast i ngarkuari me punë në Ambasadën e Amerikës, në Prishtinë, z. Michael Murphy së bashku me zëvendës ministrin Shemsi Veseli, sekretarin e Përgjithshëm, Shkëlzen Syla dhe gjeneralbrigade Zymer Halimi u dhanë mirënjohje pjesëtarëve të njësitit të Xhenios të FSK-së, për kryerjen e punimeve me përgjegjësi të madhe. Tani qendra falë këtij donacioni të SHBA-s dhe punës së palodhur të FSK-së i plotëson të gjitha kushtet e përgjithshme për kryerjen e aktiviteteve të nënave dhe fëmijëve.

Ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati vlerësuan lartë kontributin e gjeneralbrigade Françesko Diella

Ministri Agim Çeku dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati priten në vizitë lamtumirëse shefin e Divizionit Këshillues Ushtarak të NATO-s, për FSK-në, gjeneralbrigade Fracesko Diella dhe pasuesin e tij, gjeneralbrigade Michel Citadella.
Ministri Çeku dhe Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati u shprehen tejet mirënjohës për punën e palodhur të gjeneral Franceska Diella dhe ekipit që ai drejtoi gjatë misionit të tij, në Kosovë. Me këtë rast ministri Agim Çeku u shpreh i bindur se edhe gjeneral Citadella do të vazhdojë të njëjtin bashkëpunim dhe koordinim në mes FSK dhe Divizionit Këshillues Ushtarak të NATO-s.
Poashtu edhe komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati ka shpreh konsideratë të lartë për angazhimin e gjeneralit Diella gjatë aktivitetit të tij, në Kosovë, si edhe bashkëpunimin e ngushtë të shefit të Divizioni Këshillues Ushtarak të NATO-s, si edhe për gatishmërinë e trupës që ai drejtoi që të jetë afër FSK-së dhe në bashkëpunim të ngushtë.
Nga ana e tij, gjeneralbrigade Francesko Diella, falënderoi ministrin Çeku dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin për mundësitë e ofruara si edhe bashkëpunimin e treguar gjatë mandatit të tij, si shef i Divizionit Këshillues Ushtarak të NATO-s. Ai tha se përvoja e tij me FSK-në do të jetë një prej përvojave të paharrueshme, dhe se oficerët e FSK-së dhe në përgjithësi njësitë kanë treguar një bashkëpunim korrekt.



Në fund gjeneral Diella para ministrit Çeku dhe KOMFSK, gjeneral Kastrati e prezantoj edhe pasuesin e tij, në detyrë gjeneral brigade Michel Citadella.
Minsitri Çeku dhe KOMFSK, gjeneral Kastrati e uruan gjeneralin Citadella për detyrën e re si edhe i ofruan bashkëpunim në punën e mëtejshme gjatë mandatit të tij, në krye të Divizionit Këshillues Ushtarak të NATO-s.

FSK-ja filloi realizimin e projektit më të madh në komunën e Junikut

Njësiti i Inxhinierisë i FSK-së, pas realizimit të projektit në fshatin Turiqicë, komuna e Podujevës, filloi realizimin edhe të një projekti tjetër më të madh, hapjen e trasesë së rrugës në gjatësi 14 km, në komunën e Junikut. Ky projekt po menaxhohet me sukses nga Departamenti i BCU-së, të Ministrisë së FSK-së dhe po realizohet nga inxhinierët e FSK-së.
Ministri i FSK-së, Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me bashkëpunëtorë, kanë vizituar njësinë e Inxhinierisë së bashku me kryetarin e komunës së Junikut, z. Agron Kuçi, ku kanë përcjellë realizimin e projektit, hapjen e trasesë dhe shtrimin me zhavorr të rrugës e cila i lidhë fshatrat; Jasiq, Gjocaj, Zharrë, Livadhi i Madh dhe Koshare.
Ministri, komandanti dhe kryetari i komunës kanë përgëzuar inxhinierët e FSK-së, të cilët po i kryejnë punimet me sukses.
Ministri Agim Çeku, me këtë rast



ka thënë: "FSK-ja është e angazhuar në shumë projekte të infrastrukturës në shumë komuna dhe në shumë vendbanime kemi hapur dhe riparuar rrugë, etj, por ky është projekti më i madh që deri më tash ka kryer FSK-ja. Projekti i Junikut është një projekt shumë serioz, është një projekt shumë sfidues por është një projekt që ne kemi kapacitet, kemi vullnet dhe kemi mundësi ta kryejmë. Na vjen shumë mirë që sadopak kemi mundur ta ndihmojmë edhe ne komunën e Junikut, qytetarët e kësaj treve, që t'ua ofrojmë më shumë këto bukuri natyrore, që ata t'i shijojnë, t'i shfrytëzojnë, ta zhvillojnë turizmin që jetë sa më tërheqës për qytetarët jo vetëm të Kosovës. Na vjen mirë në qoftë se me këtë punë tonë do të kontribuojmë që komuna e Junikut dhe bukuritë natyrore të saj, të jenë sa më afër qytetarëve nga të gjitha trevat shqiptare. Ne nuk do të ndalemi derisa ta përfundojmë këtë projekt. Rruga është e gjatë 14 km, është sfiduese, me një terren shumë të vështirë dhe na vjen mirë që një ditë do të jemi këtu që ta përurojmë këtë rrugë së bashku.
Ndërsa kryetari i komunës së Junikut, Agron Kuçi, me këtë rast ka falënderuar FSK-në, për fillimin e realizimit të këtij projekti të rëndësishëm për Kosovën. "FSK-ja po iu del në ndihmë të gjithë qytetarëve tanë. Rruga e cila po hapet sot, paraqet parakushtin themelor për zhvillimin e turizmit në Bjeshkët e Junikut. Kjo rrugë do të sjellë të mira të jashtëzakonshme për qytetarët e komunës sonë dhe zhvillimin e gjithëmbarshëm të turizmit në Kosovë. Jam shumë i lumtur që punët po vazhdojnë sipas dinamikës së parashikuar. Kjo rrugë është pasuri kombëtare jo vetëm për komunën e Junikut, por edhe për të gjithë qytetarët e kombit etj.
Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati u shpreh i lumtur që ushtarët e FSK-së, me punën e tyre po i ndihmojnë qytetarët e Kosovës, në të gjitha pjesët e saj, atje ku kanë nevojë më së shumti. "Jam i kënaqur që FSK-ja edhe me këtë projekt po tregon se është afër qytetarit dhe komunitetit. Po dëshmojmë, se ne si ushtarë jemi të gatshëm t'i ndihmojmë qytetarët e Kosovës, si dje në fshatin Turiqicë, sot banorët e Junikut e nesër do të punojmë në pjesë të tjera të Kosovës, atje ku kanë nevojë më së shumti, u shpreh në fund gjeneral Kastrati.

Nderohet vepra e dëshmorit të kombit, gjeneralmajor Ilir Konushevci

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, në Prishtinë, përkujtohet dhe nderohet vepra e dëshmorit të kombit, gjeneralmajor Ilir Konushevci, në përvjetorin e 43-të të lindjes. Për të shënuar këtë përvjetor, morën pjesë familjarë të dëshmorit, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli, oficerë dhe bashkëluftëtarë të dëshmorit Konushevci. Fillimisht para Bustit të Ilir Konushevcit vendosën kurora me lule të freskëta.
Për veprën dhe heroizmin e Ilir Konushevcit foli zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli i cili pos tjerash tha, se; "kontributi i Ilir Konushevcit gjatë luftës është shumë i madh, sidomos në organizimin dhe themelimin e Logjistikës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pastaj në udhëheqjen e luftës si ushtarë dhe si gjeneral.
Vepra e gjeneral Konushevcit edhe sot është shembull për ne, se si duhet organizuar dhe furnizuar çdo ushtri: komandë, batalion dhe njësit. Edhe në të ardhmen gjeneral Ilir Konushevci do të mbetet shembull i organizatorit dhe strategut të shquar gjatë Luftës sonë Çlirimtare, Ai do mbetet shembull edhe për ne pjesëtarët e FSK-së. Ne sot po përkujtojmë me pietet punën dhe veprën e tij të madhe, që dha për Lirinë e Kosovës", tha në fund gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli. Para bustit të dëshmorit; bashkëluftëtarët, familjarë, ushtarë dhe oficerë të FSK-së, bënë nderime dhe vendosen lule të freskta.



Intervistë me rreshterin Naim Baftiu, pjesëtar i Brigadës për Reagim të Shpejtë në Batalionin e Tretë, të FSK-së, për gazetën e FSK-së, "Forca jonë"

Naim Baftiu shpallet rreshteri më i miri në Gjermani dhe kthehet me dy çmime

90 pjesëtarë të FSK-së, kanë qëndruar për një trajnim tre javor në Qendrën Ushtarake Amerikane, në Gjermani, ku kanë pasur trajnime të nivelit më të lart me standarde të NATO-s. Nënoficerët e FSK-së, me paraqitjen e tyre kanë arrit rezultate të shkëlqyeshme dhe kanë befasuar për të mirë. Në mesin e tyre dallohet rreshteri Naim Baftiu, pjesëtar i Brigadës për Reagim të Shpejtë, në Batalionin e Tretë, të FSK-së, në Mitrovicë, me të cilin bëmë një intervistë për gazetën e FSK-së, "Forca jonë"



"Forca jonë": *Cilat janë përshtypjet tuaja, pas trajnimeve në Qendrën Ushtarake Amerikane, në Gjermani?*

Rreshter Baftiu: Gjatë trajnimit tre javor në Gjermani për lidership kemi përfituar një eksperiencë shumë të madhe nga ushtritë e botës pjesëmarrëse në këtë qendër e në veçanti përvojën më të madhe e kemi nga ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjatë tri javëve sa kemi qëndruar në këtë qendër amerikane, në Gjermani kemi pasur trajnime të ndryshme për lidership, sidomos të udhëheqjes të skuadrës në Beteja ku njësiti ynë ka treguar rezultate të mira dhe ka pasur paraqitje të shkëlqyeshme duke u nisur edhe nga përvojat e tyre të luftës, gjegjësisht edhe të trajnimit që kemi bërë për gjatë kësaj kohe, si pjesëtarë i FSK-së, së bashku me pjesëtarët e ushtrive të NATO-s pjesëmarrës në Akademinë Amerikane, në Gjermani.

"Forca jonë": *Si u vlerësua paraqitja e nënoficerëve të FSK-së, në këtë akademi?*

Rreshter Baftiu: Në Akademinë Ushtarake Amerikane kemi pasur paraqitje të shkëlqyeshme edhe si ekip dhe si individë, ku nënoficerët e FSK-së, për paraqitjen e shkëlqyeshme janë vlerësuar lartë nga oficerët e lartë të Akademisë. Kjo ishte një përvojë e shkëlqyeshme me nivelin e lartë të trajnimeve, çka për neve ishte një përvojë e re, e sidomos ushtrimi i krijimit të njësisë së lidershipit të betejave luftarake.

Rreshter Baftiu, gjatë trajnimit tre javor në Gjermani, pjesëtarët e FSK-së, patën paraqitje të shkëlqyeshme, me çka u nderuat, me dy çmime?

Rreshter Baftiu: Në Akademi si njësit kemi arrit siç thash më parë, me rezultate të mira, si individë jam nderuar me dy çmime; çmimi për lidership në nivel të Kompanisë dhe çmimi i dytë; ndërtimi i komandës. Për mua janë një privilegj i madh fitimi i dy çmimeve. Kjo është edhe një arsye më e madhe që më bënë, që të gjitha këto mësime teorike dhe praktike, të gjitha njohurit e marra t'i barti tek ushtarët e mi, në FSK-së.

"Forca jonë": *Si ja dolët që t'i arrini t'i kryeni me sukses trajnimet e nivelit të standardeve ushtarake të NATO-s, dhe cili është mesazhi i juaj për nënoficerët e FSK-së ?*

Rreshter Baftiu: Duke pas për bazë rëndësinë e pjesëmarrjes sonë në Qendrën Ushtarake Amerikane, nuk na mungoi angazhimi vetëmohues dhe falë disiplinës dhe qëllimit të vetë pjesëmarrjes, ne arritëm, që trajnimet e nivelit të standardeve të NATO-s, t'i realizojmë me sukses. Çdo pjesëtarë i FSK-së, ia arrin qëllimit t'i përballojë këto dhe trajnimet më të avancuara me sukses, por edhe realizimin e çdo detyre që del para, vetëm duke e pasur, gjithmonë, parimin për bazë, se: "unë jam më i miri dhe nuk ka detyrë që s'e kryejë me sukses"

Ky ishte suksesi më i madh i nënoficerëve të FSK-së, në trajnimin-ndërtimin e nënoficerëve, që është baza kryesore për ndërtimin e çdo ushtrie.

FSK-ja pranon nga Mbretëria e Danimarkës një donacion librash prej 420 ekzemplarësh

Në kazermën „Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore(KFT) të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Prishtinë, në prezencën e zëvendësministrit të FSK-së, Bejtush Gashi, shefit të Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, kolonelit Ertan Varlik, shef i mentoruesve të KFOR-it në FSK, oficerëve dhe ushtarëve është bërë pranimi dhe dorëzimi i një donacioni prej 420 ekzemplarësh librash nga Mbretëria e Danimarkës.

Zëvendësministri Bejtush Gashi falënderoj Mbretërinë e Danimarkës në emër të ministrit të FSK-së për ndihmën që po japin në vazhdimësi për Forcën e Sigurisë së Kosovës duke kontribuar në shumë fusha me donacione për FSK-në, si në trajnime të ndryshme dhe mbështetje të pakursyer .

Me fjalë rasti në emër të donatorit nga Danimarka e ka mbajtur mentoruesi danez nënkolonel Holger Fuglsang Dangard i cili tha, se pas donacionit të parë të librave, donacionit me pajisje për zjarrfikje, trajnimit të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza është ky donacioni i radhës me libra në lëmi ushtarake mbi teknikat e luftës, pajisjet ushtarake dhe histori të luftërave e që më vonë do ta plotësojmë këtë bibliotekë edhe me libra specialistike.

Kolonel Naim Haziri theksoi rëndësinë e këtij donacioni dhënë Bibliotekës së FSK-së, duke falënderuar shtetin e Danimarkës dhe shprehu respektin e thellë të bashkëpunimit midis dy shteteve duke vlerësuar lartë rëndësinë e librit. Kolonel Haziri theksoi, që; "Ne, në kuadër të FSK-së, kemi të hapura dy biblioteka të cilat janë komplet donacion nga shumë shtëpi botuese dhe falënderoj të gjithë për kontributin që kanë dhënë në pasurimin e këtyre bibliotekave, dhe në të ardhmen do të hapim edhe biblioteka tjera, në të gjitha njësitet e FSK-së, me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të gjithë personelit të FSK-së.

Ndërsa nënkolonel Shemsi Syla, komandant i Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza falënderoj të pranishmit dhe në veçanti Qeverinë e Mbretërisë së Danimarkës, për kontributin që po i jep FSK-së dhe në veçanti Njësisë të cilën ai e komandon.





Atletikë / Në kazermën e KDS-së në Ferizaj u mbajtën garat në atletikë

Rrahim Mani dhe Manushaqe Nuha më të mirët në 3 000 dhe 5 000 metra

- Në organizim të Komandës së Forcave Tokësore, (KFT) në ambientet e Kazermës e KDS-së, në Ferizaj, u mbajt krosi pranveror, për pjesëtarët e FSK-së. Në garën finale morën pjesë 108 pjesëtarë, prej tyre dhjetë femra. Shtegu për ushtarë ishte pesëmijë metra, kurse për ushtare tremijë metra.

Në pesëmijë metra i pari arriti Rrahim Mani i cili këtë shteg e kaloi për 16.50 sekonda, ndërsa në tremijë metra, vendin e parë e zuri kadetja e Qendrës për Studime Universitare (QSU) Manushaqe Nura.

Me këtë rast, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli i përgëzoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së, për punën dhe për angazhimin maksimal dhe njëherit kërkoi nga ata që të vazhdojnë edhe më tej, me punë sistematike, me ushtrimet e përditshme me qëllim të mbajtjes së kondicionit.

Në fund, më të mirëve, gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli, kolonele Irfete Spahiu dhe kolonel Naim Haziri u dhanë; kupa, medalje dhe mirënjohje.

FORCA JONË

* * * Viti I • Nr. 3 • Gusht 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Italisë pritet me nderime nga Garda Ceremoniale e FSK-së

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, ka prit shefin e Shtabit të Ushtrisë së Italisë, gjeneralin Abrate Biagio. Ministri Çeku, me këtë rast, ka falënderuar Shefin e Shtabit të Ushtrisë së Italisë për ndihmën që Italia vazhdimisht po jep për Kosovën dhe FSK-në. Pastaj e njoftoi me të arriturat e FSK-së, për plotësimin e Kapaciteteve Operacionale dhe detyrat që e presin FSK-në, në të ardhmen, si; rishikimin e strategjisë së sigurisë, bashkëpunimin e FSK-së me shumë shtete të rajonit dhe të botës etj. Në fund ministri Çeku e vlerësoi lartë bashkëpunim e FSK-së me KFOR-in dhe ekipet këshilluese të NATO-s.
Po ashtu u diskutuan edhe mundësitë e trajnimit të pjesëtarëve të FSK-së në Itali, në fusha të caktuara profesionale. Ndërsa, shefi i Shtabit të Ushtrisë së Italisë, gjenerali Abrate Biagio, ka shprehur gatishmërinë për ta ndihmuar edhe më tej FSK-në në të gjitha fushat që ka nevojë.
Të dy palët u pajtuan se ky bashkëpunim i mirë do të mund të thellohej dhe zyrtarizohej edhe më mirë përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të dy ministrive.
Në takim morën pjesë, zëvendës ministri Shemsi Veseli, gjeneralët: Imri Ilazi, Gëzim Hazrolli dhe koloneli Ilir Qeriqi. Ndërsa shefi i Shtabit të Ushtrisë së Italisë, gjeneral Abrate Biagio shoqërohej nga gjeneralët: Luigji F. De Leverano, Michele Cittadella dhe oficerë të tjerë madhorë.



Zëvendësambasadorja e SHBA-ve vizitoi MFSK-në



Ministri i FSK-së Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati kanë prit në takim zëvendës ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, zonjën Kelly Degnan. Ministri Agim Çeku fillimisht i ka uruar zonjës Degnan, detyrën e re të zëvendës ambasadores në Prishtinë si dhe e ka njoftuar me të arriturat e FSK-së.
Qëllimi i vizitës së zëvendës ambasadores Degnan në FSK, kishte karakter njoftimi me detyrën e re dhe për vazhdimin e bashkëpunimit të Ambasadës së SHBA-ve edhe të FSK-së.

Ministri Agim Çeku ka dekoruar ambasadorin Dell me medalje për "Shërbim meritor"

FAQE 3



Një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë vizitoi FSK-në

Ministri i FSK-së, Agim Çeku falënderon Shqipërinë për ndihmën dhënë FSK-së

Zëvendësministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë Arian Starova ka qëndruar për një vizitë pune, në Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) ku u prit nga ministri Agim Çeku dhe zëvendësministri Bejtush Gashi.

Ministri Çeku, me këtë rast, e ka falënderuar zv. ministrin Starova për ndihmën që Shqipëria po i jep Forcës së Sigurisë të Kosovës si dhe e ka njoftuar me trajnimet, shkollimin dhe bashkëpunimin e FSK-së, në rajon dhe më gjerë. Gjithashtu zëvendës ministri Arian Starova në emër të Ministrisë dhe popullit të Shqipërisë e ka falënderuar ministrin Çeku për ndihmën që FSK-ja i ka dhënë Shqipërisë, gjatë vërshimeve në Shkodër, etj.
Më pastaj, ka vazhduar takimi i të dy grupeve punuese të udhëhequr nga zv. ministri Bejtush Gashi, Haxhi Shala drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane dhe kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri të FSK-së, dhe delegacioni i Mbrojtjes së Shqipërisë kryesohej nga zv. ministri Starova, Adriatik Mema, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes dhe major



Ermir Begaj, specialist në Drejtorinë për Marrëdhënie me Jashtë.
Qëllimi i takimit të grupeve punuese të dy delegacioneve ishte implementimi i planit të veprimit të hartuar kohë më parë, nga ministrat Çeku dhe Imami, për caktimin e fushave të bashkëpunimit në mes të dy ministrive.
Delegacioni nga Shqipëria, ka vizituar edhe Komandën e Forcave Tokësore (KFT) ku u prit nga zëvendëskomandanti i saj, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli i cili përmes një brifingu e njoftoi zëvendës ministrin Starova me të arriturat dhe objektivat e FSK-së, në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, etj.
Zëvendës ministri Arian Starova pas takimeve është shprehur i impresionuar me të arriturat që ka bërë FSK-ja, për këtë periudhë të shkurtër kohore si dhe ka premtuar që edhe në të ardhmen Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë do ta ndihmojë FSK-në.

Shefi i Ushtrisë së Maqedonisë qëndroi për vizitë në Ministrinë për FSK-në

Bashkëpunim i frytshëm në mes të FSK-së dhe Ushtrisë së Maqedonisë



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti në vizitë shefin e Ushtrisë të Republikës së Maqedonisë, gjeneral major Goranqo Koteski si edhe delegacionin e lartë të Ushtrisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë. Gjeneral Koteskit iu rezervua pritje me ceremoni zyrtare nga Garda Ceremoniale e FSK-së.
Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati dhe me pas ministri i FSK-së, Agim Çeku, në Ministrinë e FSK-së, zhvilluan takime të ndara me shefin e ushtrisë së Maqedonisë.
Në të dyja takimet ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati e njoftuan gjeneral Koteskin me aktivitetet dhe zhvillimet në FSK si edhe me planet dhe perspektiven e mëtutjeshme të saj. Po ashtu, ministri dhe komandanti u shprehen se marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë së Maqedonisë janë në nivel të lartë dhe shprehën gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit të mëtutjeshëm, bazuar në raportet e mira dhe në konkretizim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy forcave dhe të dy vendeve.
Pas takimeve me ministrin Çeku dhe komandantin e FSK-së gjeneral Kastratin, gjeneral major Goranqo Koteski tha se fushat e bashkëpunimit ndërmjet Ushtrisë së Maqedonisë dhe FSK-së janë shumë të gjera dhe konkrete.
Gjeneral Koteski po ashtu deklaroi se Ushtria e Maqedonisë ka ofruar poligonin ushtarak në Krivollak për nevoja të FSK-së si edhe ritheksoi gatishmërinë e tyre për shkollimin e kadetëve të FSK-së (nga radhët e komuniteteve), në Akademinë Ushtarake në Shkup.
Më tej shefi i Ushtrisë së Maqedonisë tha se shpresojmë që sa më shpejt FSK-ja te jetë eksportues edhe më i madh i paqes në rajon e më gjerë.
Delegacioni i lartë i Ushtrisë në krye me gjeneral Koteskin vizituan Komandën e Forcave Tokësore, përkatësisht Qendrën për Studime Universitare të FSK-së në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë.



Ministri i FSK-së, Agim Çeku priti në vizitë lamtumirës atasheun ushtarak të Holandës

Me rastin e përfundimit të mandatit në cilësinë e atasheut ushtarak të Holandës, nënkolonel Ton Koedam si dhe në prezencën e ambasadorit të Holandës në Kosovë, z. Robert Bosch . Në takim ishte prezent edhe ambasadori i Holandës në Kosovë z. Robert Bosch,
ministri Çeku shprehu falënderimin e tij dhe të FSK-së për bashkëpunimin e ndërsjellët në shumë fusha, në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ushtrisë së Holandës
Ministri Çeku shprehu gatishmërinë e tij për vazhdimin dhe forcimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Holanda gjatë kësaj kohe ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për FSK-në, duke theksuar pjesëmarrjen në marshin tradicional të pjesëtarëve të FSK-së në Njemengen të Holandës, trajnimin për zhytës të pjesëtarëve të Kërkim-Shpëtimit në Vlorë të Shqipërisë, donacionet me pajisje për sallën sportive në KDS-Ferizaj e Istog dhe disa projekte humanitare.
Ndërkaq nënkolonel Koedam tha se ka qenë kënaqësi të jesh atashe ushtarak në Kosovë dhe të bashkëpunosh me FSK-në. Gjatë kësaj kohe Forca e Sigurisë së Kosovës ka pasur ngritje të jashtëzakonshme në shumë fusha. Holanda ka mbështetur FSK-në në shumë trajnime dhe projekte humanitare dhe kjo ndihmë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ky bashkëpunim intensiv bazohet në memorandumin e bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Holandës të nënshkruar më 23 dhjetor 2009dhe nënshkrimin e planit bilateral në vitin 2011.

Në Akademinë për Informim dhe Komunikime të Ushtrisë Gjermane, në Strausberg

U mbajt seminar për personelin e MFSK-së; Forcat e Armatosura në Demokraci



Në kuadër të bashkëpunimit bilateral mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë, në Berlin, me ftesë të ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë, qëndroi një delegacion i lartë i Ministrisë dhe i Forcës së Sigurisë të Kosovës, në një seminar nga data 02-07.07. 2012 të mbajtur në Akademinë për Informim dhe Komunikime të Ushtrisë Gjermane në Strausberg dhe Berlin. Pjesëmarrësit e seminarit: Haxhi Shala, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane, kryesues i delegacionit, Gjeneralbrigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve, kolonel Naim Haziri, shef i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, (KFT) kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, kolonel Skënder Zhitia, drejtor i Departamentit të Personelit, Farije Sadiku, drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Financave, Zijadin Bajqinca, drejtor i Departamentit të Logjistikës, Florin Hoxha, asistenti i Sekretarit të Përgjithshëm dhe nënkolonel Haki Hoti, shef i Sektorit për Plane, Programe dhe Analiza.
Tema bosht e seminarit ishte: Forcat e armatosura në demokraci, si dhe çështjet e tjera që u debatuan në këtë seminar, kishin të bëjnë me demokracinë në forcat e armatosura, respektivisht me udhëheqjen e brendshme të Forcave të Armatosura.
Gjithashtu u trajtuan edhe shumë çështje që kanë të bëjnë me rregullat e veprimit, kodin disiplinor, ligjet themelore dhe zhvillimin e karrierës në Forca të Armatosura.
Përveç pjesës teorike dhe praktike, seminaristët realizuan takime me interes të veçantë, në Parlamentin Gjerman, në Shoqatat e Bundeswehrtit Gjerman, ndërsa në Parlamentin Gjerman, delegacioni i MFSK-së, u prit nga njohësi i mirë i Kosovës, deputeti Schwarz
Gjatë mbajtjes së këtij seminari, delegacioni i MFSK-së u informua edhe mbi proceset e zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Gjermanisë.
Seminari ishte i një niveli shumë të lartë dhe me interes të veçantë, për delegacionin e MFSK-së, të cilët u njohën me përvojat e ushtrisë gjermane dhe gjatë seminarit pati edhe shkëmbime të përvojave nga të dyja palët.

Caktojnë prioritetet e bashkëpunimit për vitin 2013

Ministri i FSK-së, Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati kanë pritur në takime të ndara një delegacion të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë .
Komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati e ka pritur delegacionin shqiptar të kryesuar nga Rezart Bejkaj, drejtor për Marrëdhënie me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.
Po ashtu edhe ministri Agim Çeku së bashku me zëvendësministrin Shemsi Veselin dhe kolonel Ilir Qeriqin e kanë pritë dhe kanë zhvilluar një takim pune me delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë .
Ministri dhe komandanti i FSK-së e kanë njoftuar delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, për zhvillimet dhe të arriturat e FSK-së.
Më pastaj delegacioni i Republikës së Shqipërisë ka mbajtur takime pune në Ministrinë e FSK-së, me departamentet përkatëse, ku kanë biseduar për realizimin e planit dypalësh të bashkëpunimit për këtë vit si dhe planifikimin e planit të bashkëpunimit për vitin 2013.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministria e FSK-së organizoi ceremoni lamtumirëse për ambasadorin Kristofer Dell dhe kolonel Arthur Beauchamp

Në Ministrinë e FSK-së u prit me nderime ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, z. Kristofer Dell





Për nderë të ambasadorit amerikan ishin rreshtuar kuadratet e FSK-së. Me ekzekutimin e himnit të SHBA-së dhe të Kosovës filloi zyrtarisht ceremonia lamtumirëse për ambasadorin Dell dhe atasheun ushtarak amerikan, kolonelin Arthur Beauchamp. Ministri Agim Çeku ka dekoruar ambasadorin Dell me medalje për "Shërbim meritor", ndërsa atasheun ushtarak kolonelin Arthur Beauchamp me medalje për " Shërbim të shquar" Në fjalën e tij, ministri i FSK-së, Agim Çeku, me këtë rast, tha:

Jemi këtu për ta falënderuar dhe për t'i shprehur respektin tonë z. Kristopher Dell, ambasadori i SHBA-ve dhe kolonelit Arthur Beauchamp, atashe ushtarak i SHBA-ve. Këta dy burra, që ne po i nderojmë sot, nuk na kanë nderuar vetëm neve, por në radhë të parë e kanë nderuar vendin e tyre me punën e përkushtuar dhe plot entuziazëm për Kosovën dhe popullit tonë.

Neve na vjen keq që misioni i ambasadorit Dell dhe i kolonelit Beauchamp në Kosovë po përfundojnë, por kontributi i tyre do të mbetet gjithmonë me ne.

Zotëri ambasador,

Gjatë misionit tuaj në Kosovë, ju keni qenë gjithmonë të fokusuar në forcimin e partneritetit dypalësh (bilateral) në mes vendeve tona. Me përkrahjen tuaj, Programi i Partneritetit Shtetëror me Gardën e Kombëtare të Ajova-s dhe të FSK-së është realizuar dhe tash po zbatohet me sukses. Kemi realizuar një qëllim dhe një ëndërr të kamotshme. Përkrahja juaj për të filluar rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë ka qenë vendimtare.

Ju na mbështetët që për herë të parë institucionet e Kosovës të ndërtojnë institucione të mbrojtjes dhe sigurisë çfarë i nevojiten Kosovës.

Ne kemi pranuar vitin e kaluar një donacion prej 2.5 milionë dollarësh për projektin e sistemit për menaxhimin e informatave. Ky projekt është bërë në partneritet të ngushtë me NATO-në.

Ambasadori Dell, po ashtu, ishte shtytësi kryesor që për herë të parë të nënshkruhet Marrëveshja e Statusit të Forcave në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara. Gjatë takimit tim me zëvendës sekretarin gjeneral të NATO-s në qershor, Kosova është lavdëruar për progresin e e FSK-së. Ky progres i zhvillimit të FSK-së në një forcë kompetente, të aftë dhe profesionale është arritur me përkrahjen e pa rezervë të tuajën dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Amerika do të jetë vend të cilin populli i Kosovës gjithmonë do ta ketë në zemër. Ne do t'i kujtojmë fjalimin dhe mesazhet e juaja frymëzuese në ceremoninë e nderimit të Komandës në FSK. Ambasador, ju faleminderit për bashkëpunimin dhe miqësinë tuaj të jashtëzakonshme, përshëndeti në fund ministri Agim Çeku.

Ministri Çeku me një fjalë rasti falënderoi edhe kolonelin Arrthur Beauchamp, i cili ka dhënë kontribut të veçantë në ndihmë të FSK-së.

Koloneli Beauchamp ka qenë forcë shtytëse për dërgimin e Atasheut të Parë nga Republika e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lidershipi i tij ishte i rëndësisë së veçantë në ndihmë të FSK-së dhe Qeverisë së Kosovës, për të siguruar përkrahje nga Departamenti i Mbrojtjes për të asistuar FSK-në dhe Qeverinë në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Vizioni strategjik i kolonelit Beauchamp ka qenë thelbësor në ndihmë të FSK-së, për t'i përmirësuar kapacitetet e saj, në dy fusha të veprimit: Evitimin e Rreziqeve nga Mjetet e Pashpërthyera si dhe për Kërkim-Shpëtim. Koloneli Beauchamp ka zhvilluar një plan strategjik, ku ka ndihmuar në marrjen e një fondi prej 5 milionë dollarësh, për t'i trajnuar dhe pajisur njësitet e FSK-së, për deminim, kërkim-shpëtim etj.

Gjatë kohës së tij, mbi 200 pjesëtarë të FSK-së kanë kryer trajnime, ky është numri më i lartë i pjesëtarëve të FSK-së që kanë kryer trajnime të nivelit të lartë profesional të FSK-së.

Koloneli Beauchamp ndihmoi për të ndërtuar Korpusin e nën-oficerëve profesional të FSK-së.

Lidershipi i kolonelit Beauchamp ka qenë i rëndësishëm në pranimin e rekomandimit pozitiv mbi Kapacitetet e Plota Operacionale që është dhënë nga komandanti i KFOR-it.

"I dashuri Kristofer, i dashuri Arthur, falënderimet më të ngrohta për ju, punën i dhe kontributin tuaj të jashtëzakonshëm. Gjithmonë ka qenë mirë kur e dinim se mund të llogarisnim tek ju për të shkuar edhe një hap më tutje. Ju do të na mungoni, por entuziazmi dhe përkushtimi i juaj do të kujtohen përgjithmonë në Kosovë. Ju do të jeni të mirëseardhur dhe ju presim që të ktheheni përsëri. Kosova është dhe do të jetë shtëpia e juaj"- tha në fund ministri Agim Çeku.

Duke përshëndetur ministrin Çeku, gjeneralët, oficerët, aleatët e NATO-s, ambasadori Dell tha: Me ministrin Çeku fillimisht kemi punuar kur është përgatitur të marr udhëheqjen e TMK-së, si komandant i parë i asaj trupe. Unë kamë qenë shumë i gëzuar kur ministri Çeku e ka marrë detyrën e kësaj ministrie, në shkurt të vitit 2011. E dija se FSK-ja ishte në duar të sigurta me ardhjen e tij. E dija se Çeku ishte njeriu i duhur në kohën e duhur për ta udhëhequr edhe një herë transformimin e FSK-së, sepse ai gjatë transformimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Trupat Mbrojtëse të Kosovës ka qenë në krye të kësaj ushtrie dhe pastaj në krye të trupave të FSK-së. Dhe pikërisht është njeriu i duhur për ta çuar përpara FSK-në, deri sa të bëhet përmbyllja e Pavarësisë së mbikëqyrur.

Derisa i shoh këtu të gjitha të arriturat e FSK-së, siç ishte aksioni i shpëtimit në Dragash, apo ndihma e juaj në Shqipëri, për t'u përballur me vërshimet atje, si dhe aksionet e tjera në zjarrëfikje dhe të arriturat e tjera të panumërta, e di se jeni duke u zhvilluar në një forcë të tillë që i nevojitet Kosovës, Ju po bëheni pikërisht një forcë shumetnike, profesionale e sigurisë, e cila është simbol i Kosovës dhe asaj çka aspiron të bëhet.

Shpresoj se në të ardhmen do t'ju shohim krah për krahë me popujt e tjerë të Shteteve të Bashkuara dhe të shteteve aleate të NATO-s, shteteve në rajon dhe më gjerë, tha pos tjerash ambasadori Dell. Në fund ambasadori Dell dhe koloneli Beauchamp kanë falënderuar ministrin Çeku dhe kanë uruar FSK-në për arritje të mëtejme.

Në ceremoninë e pritjes të ambasadorit Dell dhe atasheut ushtarak, kolonel Arthur Beauchamp, morën pjesë edhe zv. ministrat; Shemsi Veseli, Bejtush Gashi dhe Slavisha Filipoviq, zëvendës komandanti i KFT gjeneral Gzim Hazrrolli, gjeneral Imri Ilazi, gjeneral Enver Cikaqi, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Syla, si dhe oficerët e lartë të FSK-së, drejtor të departamenteve dhe drejtorive të MFSK-së, përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të FSK-së, përfaqësuesit e KFOR-it, këshilltarët e Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK, si dhe atashetë ushtarak në Kosovë.



18 pjesëtarë të FSK-së përfundojnë me sukses marshimin në Holandë

FSK-ja kthehet me medalje nga marshimi në Holandë



Kontingjenti i FSK-së, për herë të dytë, kthehet me sukses të plotë, nga Holanda, ku mori pjesë në marshin tradicional të 96-tin me radhë të mbajtur në qytetin Nijmegen.
Marshi tradicional u mbajt, për katër ditë me radhë, nga data 19-23 korrik 2012, në qytetin Nijmegen të Holandës. Sipas rregullave të marshit, çdo ditë ekipet kanë marshuar nga 40 kilometra. Në këtë marrshim kanë marrë pjesë pjesëmarrës nga shumë shtete të NATO-s dhe të shteteve të tjera të botës.
Forcën e Sigurisë të Kosovës, këtë vit, e kanë përfaqësuar tetëmbëdhjetë pjesëtarë, në mesin e tyre morën pjesë edhe dy pjesëtare të FSK-së.
Kontingjenti i FSK-së edhe këtë vit, është kthyer me sukses të plotë, të gjithë pjesëtarët e FSK-së si njësitë arrijnë me kohë në cak. Ndërsa vitin e kaluar njësiti i FSK-së shënoi suksesin më të madh, duke hyrë në histori të



shtet e ka shënuar në historinë 95 vjeçare të këtij marshimi, ku të gjithë pjesëmarrësit si ekip e kalojnë marshimin katërditor. Kjo është hera e dytë që njësiti i FSK-së e arrin suksesin e vitit të kaluar, komplet të kalojë shtegun prej 160 km.
Për të përcjellur finalen e marshimit, në Nijmegen, kishin marrë pjesë; ambasadori i Republikës se Kosovës në Mbretërinë e Holandës, z. Nexhmi Rexhepi dhe zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, të cilët së bashku kanë bërë edhe shpërndarjen e medaljeve për të gjithë pjesëtarët e kontingjentit të FSK-së, pas përfundimit me sukses të këtij marshimi. Për arritjen e këtij suksesi, major Krasniqi, ka thanë se: "Motivimi, disiplina, entuziazmi kanë qenë faktorët kryesor që kanë bërë që Kontingjenti i FSK-së, të zë vendin e parë, por ka qenë edhe gatishmëria e ushtarëve për të realizuar misionin e marrë nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Gjatë gjithë kohës, që nga nisja, zbarkimi, mbajtja e garës, kontingjenti i FSK-së ka qenë në nivel shumë të lartë të kryerjes së detyrave. Me këtë fitore konsideroj se FSK-ja po bënë histori që dy vjet rresht duke zënë vendin e parë", thotë në fund major Krasniqi.

këtij marshimi tradicional si ekipi i dytë që kishte arrit të hynte në cak.
Marshimi ka pasur rregullat e veta të rrepta, na thotë majori Ali Krasniqi, udhëheqës i kontingjentit të FSK-së, ku secili ekip është dashtë ta kryejë marshimin në kohën e caktuar dhe si ekip. Marshimi nuk ka qenë garë shpejtësie, se kush po hyn i pari në cak, por, suksesi është matur si ekip, d.m.th. të gjithë pjesëtarët e ekipit është dashur që më kohë të arrijnë në cak.
Kontingjenti i FSK-së është shpërblyer me një medalje si ekipi më i mirë si dhe me medalje individuale.
Sipas statistikave të organizatorit, ekipi i FSK-së, vitin e kaluar, ka arritur suksesin më të madh si ekip që vetëm një




Njësia e zhytësve të FSK-së mbajti trajnimin e koduar "Fokat në veprim" në Liqenin e Batllavës

'Fokat në veprim' trajnim profesional i zhytësve nën 30 metra thellësi në ujëra



Njësiti i zhytësve i Kompanisë së Kërkim-Shpëtimit që vepron në kuadër të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, ditë më parë realizoi me sukses të plotë trajnimin njëjavor, në Liqenin e Batllavës. Katërmbëdhjetë zhytësit e njësisë së kërkim-shpëtimit, që në orën tetë, prisnin si zakonisht të gatshëm urdhrin e komandantit të tyre, kapiten Ali Selimit, për fillimin e zhytjes në Liqenin e Batllavës.
Njësiti është plotësisht i gatshëm për veprim, të gjithë pjesëtarët janë të përgatitur në aspektin psikik dhe profesional, na thotë që në fillim të bisedës, komandanti i njësisë kapiteni Ali Selimi.
Këtë e kanë dëshmuar dhjetëra herë gjatë intervenimeve të shumta, në situata të ndryshme, qoftë në ujëra, qoftë në tokë.
Për sukseset e arritura gjatë intervenimeve dhe për profesionalizmin e treguar, njësiti i zhytësve është dekoruar me medalje dhe mirënjohje nga presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati etj.
"Ky është vazhdim i trajnimeve të ashtuquajtura rifreskuese, këto trajnime i mbajmë në vazhdimësi, me qëllim të mbajtës së kondicionit dhe të formës, për të qenë gjithmonë profesionalisht të gatshëm për intervenime, në raste të ndryshme dhe të paplanifikuara, kur këtë e kërkojnë nga ne, sepse ne duhet të jemi gjithmonë të gatshëm", thotë kapiten Selimi.
Kur është fjala për trajnimet; kapiten Selimi, tregon se vitin e kaluar kanë kryer me sukses një trajnim certifikues dyjavor në qytetin e Vlorës, në Shqipëri; menaxhuar nga instruktorët e Marinës së Holandës së bashku me njësitin e zhytësve të FSK-së, kanë qenë edhe nga një njësit i zhytësve të ushtrisë së Maqedonisë dhe të Republikës së Shqipërisë.
Zhytësit e FSK-së në këtë trajnim certifikues; kanë arritur sukses të meritуar: nëntë prej tyre e kanë fituar titullin zhytës me dy yje dhe katër zhytës me një yll.
Në trajnimin e sotëm, që po e mbajmë në Liqenin e Batllavës, kemi angazhuar edhe pesë pjesëtarë të rinj, për të cilët janë të domosdoshme trajnimet fillestare bazike. Trajnimi rifreskues bëhet për të dy nivelet; niveli i zhytësve me dy yje zhvillohet në thellësi nën 30 metra, ndërsa, niveli për fillestarë zhvillohet në thellësi deri në 30 metra.
Vitin e kaluar kemi pasur disa intervenime, në Kosovë dhe jashtë Kosovës, në Shkodër .
Restelica ka qenë njëra nga ngjarjet më të rënda për ne, me vetë faktin se aty kanë humbur jetën një familje, si pasojë e rrëshqitjes së borës, ndërsa, njësiti kishte arritur që nga gërmadhat e shtëpisë së shembur ta nxjerrë të gjallë vajzën e vetme të kësaj familjeje.
Edhe përkundër mungesës së disa automjeteve më profesionale, ne, po ja dalim mbarë me sukses, ndërhyn në bisedë Valmir Kelmendi, zhytësi më i mirë, i cili për intervenime të ndryshme është nderuar me katër medalje gjatë shërbimit të tij në këtë njësitë. Valmiri edhe emrin e ka të përbashkët me valët dhe vërtet është si valët e mira.
Gjatë tërë kohës së trajnimit të zhytësve të FSK-së, ishte edhe ekipi monitorues i instruktorëve të NATO-s, të cilët në çdo moment janë përkrahë zhytësve të FSK-së, duke vëzhguar dhe duke i ndihmuar me udhëzime dhe forma të tjera.
Njësiti i zhytësve të FSK-së ka një bashkëpunim të mirë me përfaqësuesit e NATO s, kjo u vërejt edhe gjatë bisedave të tyre për zgjedhjen e vendit të trajnimit. Monitoruesit e NATO-s u shprehën se bashkëpunimi është i shkëlqyeshëm dhe se njësiti i zhytësve po arrin përvetësimin e metodave më profesionale, me çka kanë treguar suksese edhe gjatë intervenimeve në shumë raste.
Komandanti i njësisë së zhytësve na tregon se vitin e kaluar kanë pasur shumë intervenime të suksesshme, në Shkodër gjatë vërshimeve; ku njësiti i FSK-së, dy herë ka marrë pjesë për ta ndihmuar popullatën e Shkodër me ç'rast për arritje të jashtëzakonshme në ndihmë qytetarëve të Shkodrës me rrethinë janë dekoruar me medalje nga presidenti i gjejmë te liqeni i Batllavës, i cili neve na i plotëson të gjitha kriteret për një trajnim të suksesshëm.
Njësia e zhytësve deri më tani është shpërblyer me shumë medalje për arritje të jashtëzakonshme gjatë intervenimeve të shumta, kudo ku kanë marrë pjesë pjesëtarët e kësaj njësie.
Ndërsa nga Shpella e Zgatarit, e cila është e pa hulumtuar deri më tani dhe me plotë rreziqe të paparashikueshme, me një thellësi mbi tetëdhjetë metra, tre pjesëtarë të këtij njësiti, arrijnë ta nxjerrin trupin e pajetë të një qytetari. Intervenimi kryhet me sukses dhe për këtë komandanti i FSK-së, gjen-





erallejtënant Kadri Kastrati u ka dhënë medalje tre pjesëtarëve që kanë marrë pjesë në këtë intervenim, Ali Selimit, Valdrin Kelmendit dhe Azem Gashit, me motivacionin për trimëri dhe profesionalizëm.
Komandanti i kërkim-shpëtimit premtoi se së shpejti Njësiti i zhytësve do t'i ketë edhe instruktorët e vetë në këtë lëmi. Ne së shpejti do ta mbajmë një trajnim për certifikimin e instruktorëve të FSK-së, ku do të marrin pjesë nëntë pjesëtarë të cilët e kanë nivelin me dy yje.
Në fund komandanti i Njësisë së kërkim-shpëtimi, kapiteni Ali Selimi, tregon se, për t'i kryer detyrat sa me më sukses i nevojiten edhe disa mjete teknike; automjete transporti dhe barka për intervenim në ujëra.
Ndërsa zhytësi më i mirë është shpallur Valdrin Kelmendi, i cili për merita të jashtëzakonshme ka marrë katër medalje.

Ambasada Amerikane e ndihmon FSK-në me pajisje teknike për parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë

Amerika vazhdimisht po na ndihmon jo vetëm me mjete teknike por edhe me trajnime, me qëllim të profesionalizimit



Ambasada amerikane i ka dhuruar Qeverisë së Kosovës pajisje teknike në vlerë prej 364 mijë dollarësh. Ceremonia e dorëzimit të donacionit u mbajt në Policinë e Kosovës, në Vushtrri, ku morën pjesë; zv.ambasadorja e Amerikës, zonja Kelly Degnan, gjeneral brigade Imri Ilazi nga FSK-ja, Fehmi Fejza nga AMRK-ja dhe Dejan Jankoviq nga Policia e Kosovës.
Me këtë rast zëvendës ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Kelly Degnan tha, se ndihet e lumtur që po e ndihmon Qeverinë e Kosovës me këtë donacion në vlerë mbi 364 mijë dollarësh, mjete këto të sofistikuara për inspektimin dhe detonimin, pajisje për parandalimin e armëve të shkatërrimit në masë të dhuruara nga Departamenti i Shtetit për Sigurimin e Atdheut, përkatësisht programit ndërkombëtar për parandalimin e armëve të shkatërrimit në masë.
Qëllimi i këtij donacioni është ngritja e kapaciteteve hetuese kriminale që Policia e Kosovës, FSK-ja etj, do t'i përdorin në dogana dhe vende të tjera me qëllim të evitimit të hyrjes së armëve të rrezikshme të shkatërrimit në masë në Kosovë. Qëllimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është ndërtimi i një Kosove të fortë dhe me një jetë më të sigurtë për të gjithë, tha në fund zonja Kelly Degnan.
Ndërsa gjeneral brigade Imri Ilazi, shef i Departamentit të Operativës dhe Trajnimeve, ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën e vazhdueshme që po japin për Kosovën dhe FSK-në.
"Amerika vazhdimisht po na ndihmon jo vetëm me mjete teknike por edhe me trajnime, me qëllim të profesionalizimit të njësive të FSK-së. Këto ditë pjesëtarët e FSK-së, kanë kryer me sukses trajnimin në këto fusha, si: Parandalimi apo pengimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, Detektimi i armëve të shkatërrimit në masë, Ndalimi i armëve të shkatërrimit në masë, Materialet dhe pajisja teknologjike në lidhje me armatimin e shkatërrimit në masë, hetimi i trafikut ilegal, si dhe reagimi ndaj armëve të shkatërrimit në masë etj.
Me këtë rast, gjeneral Ilazi ka falënderuar edhe instruktorët nga ICP-ja, për angazhimin maksimal që kanë bërë për aftësimin dhe përgatitjen e forcave profesionale të FSK-së, së bashku me Policinë e Kosovës dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, Doganën e Kosovës, Agjencinë për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jonizues etj.
Përdorimin i pajisjeve si dhe zhvillimi i disa ushtrimeve simulative i ka bërë pjesëtarët e FSK-së të jenë në një nivel të lartë profesional dhe të aftë që në vendin tonë të përballen me sukses kundër kërcënimit të armëve të shkatërrimit në masë.
Gjeneral Ilazi premtoi se, të gjitha pajisjet e dhuruara nga Qeveria Amerikane, do t'i përdorim dhe do t'i mirëmbajmë me sukses.
Në fund gjeneral Ilazi në shenjë respekti dhe falënderimi për SHBA-në, zëvendës ambasadores Kelly Degnan i dhuroi emblemën e FSK-së, e cila e falënderoi për këtë dhuratë të veçantë.
Vlera e pajisjeve për FSK-në, kap shumën prej 142 mijë dollarësh, ndërsa pjesa tjetër për Policinë e Kosovës dhe agjencitë tjera të sigurisë.
Qeverinë amerikane e kanë falënderuar edhe Fehmi Fejza nga AMRK-ja si dhe Dejan Jankoviq, nga Policia e Kosovës.



Për arritje të jashtëzakonshme nderohen me medalje 26 oficerë të FSK-së

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati shpërblen me medalje pjesëtarët e kësaj force për rezultatet e treguara në operacionet brenda dhe jashtë vendit



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës u mbajt një ceremoni, për ndarjen e medaljeve, për pjesëtarët e FSK-së, që kanë arritur rezultatet të shkëlqyeshme në trajnime dhe operacione ushtarake të mbajtur në Krivollak të Maqedonisë, në Nijmegdan të Holandës dhe në intervenimin në shpellën e Zgatarit, komuna e Prizrenit.
Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati me këtë rast i ka përgëzuar pjesëtarët e FSK-së: kadetët e Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, të cilët u shpallën më të mirët gjatë pjesëmarrjes në operacionin dyjavor, të mbajtur në poligonin ushtarak, Krivollak të Maqedonisë, pjesëtarët e njësisë së kërkim-shpëtimit, të cilët zunë vendin e parë, në Holandë, dhe pjesëtarët që intervenuan në nxjerrjen e trupit të pajetë, nga një shpellë, në komunën e Prizrenit.
Me këtë rast komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati i ka përgëzuar pjesëtarët e FSK-së, për arritje të jashtëzakonshme në trajnimet dhe operacionet ushtarake që morën pjesë. Me këtë rast tha gjeneral Kastratitha: "Ju në operacionet që keni marrë pjesë jashtë Kosovës, keni treguar një performancë të shkëlqyeshme, me çka jeni bërë shembull, dhe kjo është dëshmi, se FSK-ja është e aftë të t'i kryejë me sukses të gjitha detyrat. Na gëzon fakti, se këto ditë, nga Gjermania u kthyen edhe 90 nënoficerë të FSK-së, të cilët treguan një performancë të lartë, me çka është edhe një hap para në plotësimin objektivave tona. Ndarja e medaljeve është edhe një përgjegjësi shtesë, por edhe motivim më i madh për realizimin me sukses të të gjitha detyrave dhe për profesionalizimin e FSK-së, që është edhe synim i yni, për të ardhmen"..
Në fund, komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati së bashku më zv. komandantin e KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrollin, u dhanë 26 pjesëtarëve të FSK-së medaljet me motivacionin për arritje të jashtëzakonshme profesionale në realizimin e detyrave.





Kompania e Deminimit vazhdon pastrimin e territorit nga mjetet e pashpërthyera

Çminuesit e FSK-së pastruan mbi 60 mijë m² dhe shkatërruan mbi 200 mjete eksplozive

Kompania e Deminimit të FSK-së, gjatë këtij viti, ka arritur të bëjë pastrimin e mbi 60 mijë m² të territorit të minuar si pasojë e luftës, në Kosovë dhe të shkatërrojë mbi 200 predha të llojeve të ndryshme, si: projektil, granata dore, mortaja, raketa, bomba-kasetë, mina të ndryshme etj.
Ekipet e Kompanisë së Deminimit të FSK-së, po pastrojnë këto vendndodhje ; në kazermën e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj, në Harilaq, komuna e Fushë-Kosovës, në Hajvali, komuna e Prishtinës, si dhe pastrimin e fushëbetejave (BAC) dhe lokacioneve, në: Koshare dhe në Belincë, ndërsa një tog i EOD-së, kryen shërbime kujdestarie çdo 24 orë.
Ekipet e Deminimit të FSK-së, këtë vit, kanë pastruar një sipërfaqe prej 60649 m² dhe kanë shkatërruar mbi 208 MEP (mjete eksplozive të pa shkatërruara) të llojeve të ndryshme, si: projektil, granata dore, mortaja, raketa, bomba-kasetë, mina të llojeve të ndryshme etj.
Ekip EOD-së, në përgjigje të thirrjeve gjatë kujdestarisë, ka shkatërruar mbi 500 MEP të llojeve të ndryshme, si: projektil, granata dore, mortaja, raketa, bomba-kasetë ,mina të ndryshme.
Ekipet e Kompanisë së Deminimit po i përballojnë me sukses temperaturat e larta, megjithëse pajisjet mbrojtëse në trup janë mjaft të rënda dhe kjo ua vështirëson edhe më shumë kushtet e punës .
Të udhëheqësh Kompaninë e Deminimit është privilegj, por në të njëjtën kohë është edhe përgjegjësi e madhe dhe rrezik për pjesëtarët e deminimit, mirëpo falë profesionalizmit të tyre, punës që po e bëjnë me përkushtim, kanë arritur që të pastrojnë një sipërfaqe të madhe të zonave të rrezikshme, kanë gjetur shumë mjete të pashpërthyera dhe nuk ju ka ndodhur asnjë incident. Ky përkushtim i tyre na bënë të gjithëve të ndihemi krenarë për ta.
Kompania funksionon si një kolektiv i përgjithshëm ku të gjitha aktivitet janë të harmonizuara sipas zinxhirit komandues. Kujdes i veçantë po i kushtohet edhe ngritjes profesionale të pjesëtarëve të kompanisë. Një pjesëtar i saj po shkollohet në Gjermani. Të gjithë pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit meritojnë dekorata, avancime etj.
Mjetet të cilat përdoren gjatë kryerjes së operacioneve të deminimit janë të përshtatshme dhe janë në gjendje të mirë.
Gjendje jo fort e mirë i përcjell mjetet e transportit pasi që nuk ka numër të mjaftueshëm të automjeteve si dhe disa prej tyre që posedojmë janë mjaft të amortizuara. Megjithëkëtë falë profesionalizmit të pjesëtarëve të deminimit deri më sot nuk kemi pasur asnjë incident gjatë punës.





Pjesëtarët e FSK-së donatorë të rregullt të dhurimit të gjakut

FSK -ja dhuroi mbi 450 doza gjak

Dr. Safete Maliqi nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, tha: "Pjesëtarët e FSK-së janë donatorë të rregullt të gjakut dhe se çdoherë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni".
Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), filloi aksioni humanitar për dhurimin gjakut, nga Departamenti i BCU-së dhe të Mjekësisë të MFSK-së, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës(QKTGJK), aksioni është mbajtur në të gjitha kazermat e njësive të FSK-së dhe ka zgjatur dy javë, nga data 2 deri me 16 korrik 2012.
Për t'i inkurajuar të tjerët me shembullin e tyre, në sallën e improvizuar për punën e ekipeve të transfuzionit, dhuruan gjak zëvendësministri i FSK-së, Bejtush Gashi dhe ushtruesi i detyrës së komandantit të Forcave Tokësore(KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli.
Zëvendësministri Gashi tha se FSK-ja ka një traditë të organizimit të aksioneve humanitare për dhurimin e gjakut dhe se prej praktikave të kaluara, por edhe prej interesimit që të gjithë po shohim sot këtu, FSK-ja, përkatësisht pjesëtarët e saj civilë dhe ushtarakë janë të gatshëm që të dhurojnë gjak për nevoja të pacientëve.
Po ashtu edhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli u shpreh se pjesëtarët e FSK-së janë shumë entuziast në përgjigje të këtij aksioni.
Shumica prej tyre tha ai, janë dhurues të rregullt jo vetëm gjatë aksionit, por gjatë gjithë vitit.
Ndërsa Sabrije Prekaj, menaxhere për aksione të dhurimit të gjakut të QKTGJ-së, thotë së pjesëtarët e FSK-së janë donatorë të rregullt dhe se çdoherë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni.
Gjatë aksionit dyjavor, të mbajtur në të gjitha njësitet e FSK-së, janë dhuruar mbi 450 doza gjak për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.
Ekipi mjekësor i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në bashkëpunim me personelin e Kompanisë së Mjekësisë së FSK-së, vizituan të gjitha kazermat e FSK-së sipas kalendarit, për të ju mundësuar pjesëtarëve që të dhurojnë gjak pa shkëputje nga detyrat dhe aktivitetet e punës.
Ky aksion organizohet për herën e katërt. Përkundër kohës së pushimeve, trajnimeve dhe ushtrimeve, thirrjes për gjak iu përgjigjën një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së.
FSK-ja është dhuruesi më i madh i gjakut në Kosovë.
Pjesëtarët e FSK-së janë bërë një shembull i mirë për të ndihmuar qytetarët e Kosovës dhe për ngritjen e vetëdijes tek qytetarët që t'i përgjigjen aksionit humanitar për dhurimin e gjakut si dhe aksioneve dhe iniciativave të tilla humanitare.
Dr. Safete Maliqi, shefe në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, është shprehur e kënaqur me dozat e dhuruara të gjakut nga pjesëtarët e FSK-së duke u shprehur:"FSK-ja është donator i rregullt i dhurimit të gjakut dhe se çdoherë i janë përgjigjur me vullnet aksioneve të dhurimit të gjakut. FSK-ja dhe nxënësit janë dhuruesit më të mëdhenj të gjakut në Kosovë".
Aksioni humanitar i dhurimit të gjakut është realizuar në bashkëpunim BCU-së, Kompanisë së Mjekësisë së FSK-së dhe të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.



Në Ministri të FSK-së u mbajt seminari: Politikat për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Në organizim të Zyrës për Minoritete në Ministrinë e FSK-së, u mbajt seminari nga Grupi Punues për Çështje Gjinore me temën: Eksperienca për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut.



Takimin e hapi dhe udhëhoqi Azemina Qullum, shefe e Zyrës për Komunitete dhe Barazi Gjinore në MFSK. Punimet e seminarit i përcolli zëvendësministri i FSK-së Sllavisha Filipoviq.
Në takim morën pjesë përfaqësuesit e drejtave të njeriut, të ministrisë, KFT-së, dhe të njësive të tjera të FSK-së, si dhe edhe përfaqësues të NATO-s.
Çështjet kryesore të seminarit, të cilat u shtjelluan, ishin: Krijimi i mekanizmave institucionalë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, bazuar në legjislacionin e aplikueshëm dhe politikat aktuale, realizimi i bilancit të gjinive dhe komuniteteve, rritja e besimit duke forcuar rolin e gruas dhe komuniteteve në MFSK dhe FSK dhe zhvillimi i sistemit të informimit dhe bashkëpunimit me organizata relevante ndërkombëtare në MFSK dhe FSK.
Ndërsa, nënkoloneli kanadez, Wayne Gauthier, në temën e tij "Përvojat e një kanadezi" prezantoi përvojat e të drejtave të njeriut në Ushtrinë e Kanadasë. Nënkolonel Wayne Gauthier u ndal kryesisht te të drejtat e njeriut në Ushtrinë e Kanadës, siç janë raporti i të drejtave të njeriut, gjuha, pjesëmarrja e gjinisë femërore në ushtri, të drejtat e pakicave etj. Pjesëmarrësit e seminarit u angazhuan maksimalisht me pyetjet dhe interesimin e tyre për të ditur më shumë për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore në ushtrinë e Kanadasë.

Fondi i Mirëbesimit dhuron donacion për FSK-në

Fondi i Mirëbesimit "Trust Fond" i themeluar nga vendet anëtare të NATO-s, për ngritje dhe ndihmë për FSK-në, ka ndarë një donacion në formë të pajisjeve të mirëmbajtjes së automjeteve për Batalionin e Logjistikës të Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së.
Ky donacion i radhës që vjen nga "Fondi i Mirëbesimit" është shumë i dobishëm për punën e Batalionit të Logjistikës. Në këtë kontingjent përfshihen: mjete dhe vegla për ndërtimtari, komplete mekanike, mjete hidraulike, aparaturë diagnostike portative për defekte në makina, kompresor pneumatik, balancues të gomave të mëdha për makineri të rëndë, matës laserik të distancës, etj.
Pajisjet teknike të përfituara nga FSK-ja, janë të vlefshme për nevojat aktuale të FSK-së për aktivizimin dhe përdorimin efikas të mjeteve transportuese, teknikës dhe makinerisë së rëndë në kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të caktuar të plotësimit të Kapaciteteve të Plota Operacionale në kuadër të misionit saj.
Fondi i Mirëbesimit është një kontribuues shumë i madh për pajisjen dhe mbështetjen e FSK-së, dhe se burim i financimit të këtij fondi janë shtetet anëtare të NATO-s, të cilat janë duke kontribuar në ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së.

Holanda dhuron pajisje sportive për pjesëtarët e FSK-së

Brigada për Reagim të Shpejtë në Istog, përfitoi donacionin në vlerë prej 15 mijë euro



Zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore(KFT) të FSK, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, pranoi donacionin në pajisje sportive për sallën e sporteve të Kazermës "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë(BRSH) në Istog. Donacionin u nda nga Mbretëria e Holandës për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës të Komandës së BRSH-së dhe Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë në Istog.
Gjatë përurimit të sallës ku ishin vendosur pajisjet sportive, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli tha se Mbretëria e Holandës ka pas dhe vazhdon ta ketë një bashkëpunim shumë të mirë në të gjitha fushat e sidomos në trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së e më konkretisht trajnimin për zhytës të pjesëtarëve të Kërkim Shpëtimit. Gjeneral Hazrolli falënderoi shtetin e Holandës dhe nënkolonel Koedam për donacionin me pajisje sportive duke e cilësuar këtë donacion si një të mirë tjetër për pjesëtarët e FSK-së për të mbajtur dhe shtuar gatishmërinë fizike.
Kurse atasheu ushtarak i Holandës, nënkolonel Ton Koedam shprehu falënderimin e tij dhe të Qeverisë së Holandës e cila po vazhdon të ndihmoj FSK-në dhe fal këtij komunikimi dhe bashkëpunimi të mirë në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Holandës kemi arritur rezultate të mirë në trajnime të ndryshme.
Për donacionin e pajisjeve sportive Koedam tha se është kënaqësi që po kontribuojmë sadopak për t'i ndihmuar pjesëtarët e FSK-së të cilët kanë një motiv dhe fuqi për të vazhduar tutje synimet e tyre.
Në përurimin e kësaj salle ishte prezent zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i BRSH-së gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, atasheu ushtarak i Holandës Ton Koedam si dhe oficerë tjerë të FSK-së.



Ministria për FSK mbështet QKUK-në dhe Policinë e Kosovës me Serum Antiviperik

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me vendim të ministrit Agim Çeku dhe Komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ka mbështetur me Serum Antiviperik (tri doza), Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Policinë e Kosovës, me kërkesë të tyre.
Në ambientet e ministrisë u bë pranim- dorëzimi i dozave të serumit ndërmjet Major Dr. Genc Shala, zëvendëskomandant i Kompanisë së Mjekësisë dhe përfaqësuesit të QKUK-së.
Ndërsa një dozë i është dorëzuar sektorit të Mjekësisë së Policisë së Kosovës për shkak të nevojës urgjente që ishte krijuar me rastin e kafshimit nga gjarpri të një polici që kishte nevojë për Serumin Antiviperik.
Qendra Klinike Universitare ka paraqitur kërkesë për mbështetje me medikamentin Serum Antiviperik (që injektohet tek pacientet në raste të kafshimit nga gjarpinjtë), tek sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Dr. Shkelzen Sylaj, me arsyetimin se Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka mungesë të këtij medikamenti e po ashtu as Ministria a Shëndetësisë nuk e posedon një medikament të tillë.
Angazhim për koordinim dhe mbështetje ndërmori zëvendësministri i Ministrisë së FSK-së, ShemsiVeseli i cili e vlerësoi si shumë fisnike ndihmesën që FSK-ja i bëri QKUK-së në këtë situatë.
FSK-ja e ka konsideruar kërkesën imediate, dhe ka mbështetur QKUK-në me tri doza, sepse mungesa e këtij medikamenti në këto kushte të vërës, kur temperaturat janë të larta dhe se qytetarët mund të jenë të kërcënuar nga kafshimi eventual i gjarpërinjve, kërkon përgjigje të nevojshme.
Ministria e FSK-së dhe FSK-ja e ka paraparë me kohë dhe çdoherë mban të furnizuar depon e medikamenteve të Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së, për nevoja të ruajtjes së shëndetit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët janë të angazhuar në detyra të përditshme në terren, gjatë operacioneve, trajnimeve, aktiviteteve humanitare, etj. Sidomos në kushte verore FSK-ja ka marrë të gjitha masat që Serumi Antiviperik të jetë në sasi të mjaftueshme për raste emergjente.



FORCA JONË

* * * Viti I • Nr. 4 • Shtator 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë ta përkrahin zhvillimin e FSK-së



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Agim Çeku është siguruar nga zyrtarët më të lartë të administratës amerikane se SHBA-të janë të përkushtuara për zhvillimin e mëtejmë të FSK-së.

Në ditën e parë të vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së Kadri Kastrati të shoqëruar nga ambasadori Akan Ismaili dhe atasheu i Forcës së Sigurisë, gjeneral brigade Xhavit Gashi u pritën nga zyrtarët më të lartë të Departamentit të Mbrojtjes, Departamentit të Shtetit si dhe të Shtëpisë së Bardhë.

Delegacioni i prirë nga ministri Agim Çeku pati takime të ndara në Pentagon, me zëvendës-nënsekretaren e parë të Mbrojtjes për Politika, Dr. Kathleen Hicks, gjeneralin Craig R. McKinley, shefen e Zyrës së Gardës Kombëtare Amerikane, RDML Mark Mongomery, udhëheqës i zyrës për Evropën Perëndimore dhe Ballkanin, si dhe zëvendës-ndihmës sekretarin e mbrojtjes për Partneritet Strategjik dhe Operacione Stabiliteti, z. James Schear.

Delegacioni i Kosovës në kuadër të vizitës në Uashington, ka realizuar takime edhe në Departamentin e Shtetit, ku u takua me ambasadorin Philip Reeker, zëvendës-ndihmës sekretar i SHBA-ve për Evropë.

Ndërsa në Këshillin Kombëtar për Siguri Kombëtare pranë Shtëpisë së Bardhë, ministri Çeku dhe delegacioni i Kosovës zhvilluan një takim edhe me Dr. Liz Sherwood-Randal.

Në takimet që pati ministri Agim Çeku ka falënderuar bashkëbiseduesit për përkrahjen e vazhdueshme të SHBA-ve, për Kosovën dhe për FSK-në, prezantoi të arriturat e FSK-së, vizionin dhe objektivat strategjike të saj, si dhe kërkoi vazhdimin e përkrahjes së SHBA-ve, përmes partneritetit me Gardën Nacionale të Ajovës dhe programeve tjera prej të cilave përfiton FSK-ja. Në veçanti u bisedua për procesin e rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë si hap i rëndësishëm në zhvillimin e mëtejmë të FSK-së.

Ministri Agim Çeku gjithashtu kërkoi përkrahjen e SHBA-ve në integrimin e FSK-së në nisma rajonale dhe në procese integruese euro-atlantike.

Në të gjitha takimet, zyrtarët e lartë amerikanë shprehën mirënjohjen për të arriturat e FSK-së, për punën e lidershipit të saj dhe nxitën përkushtimin e mëtejmë në arritjen e objektivave strategjik duke siguruar përkushtimin e SHBA-vë për një përkrahje të vazhdueshme për zhvillimin e FSK-së.

Ajova dhe Kosova konfirmuan bashkëpunimin për të ardhmen në shumë fusha



Në shtetin Ajova të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka përfunduar punimet Konferenca për Programin Shtetëror të Bashkëpunimit ndërmjet shtetit të Ajovës dhe Kosovës.

Gjatë qëndrimit në Ajovë, ministri dhe komandanti i FSK-së, Agim Çeku dhe gjeneral Kastrati zhvilluan një varg takimesh me rëndësi dhe më interes për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Gjithashtu edhe oficerët e FSK-së së bashku me oponentët e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjatë qëndrimit të tyre në Ajovë, shkëmbyen eksperienca në shumë fusha ushtarake si edhe patën rastin të njihen nga afër dhe të vizitojnë: Qendrën Stërvitore, Qendrën Simulative si edhe Qendrën e Situatave të Komandës së Gardës Kombëtare të Aiovës.

Gjatë konferencës punuan edhe grupet punuese me panele profesionale të cilat ishin funksionale dhe praktike, në kuptimin më të mirë të gjendjes së sigurisë, gjendjes politike dhe sociale në Kosovë.

Konferenca treditore ishte e përqendruar në planet dhe synimet për të ardhmen në kuadër të Programit Shtetëror të Partneritetit Ajovë-Kosovë. Me këtë rast u konfirmua
edhe bashkëpunimi për të ardhmen në mes dy vendeve. Kështu në shtator të këtij viti, Ministrinë dhe Forcën e Sigurisë të Kosovës do ta vizitojë një delegacion i lartë ushtarak dhe civil nga Aiova, në krye me gjeneral-majorin Timoti Orr, komandant i Gardës Kombëtare të shteti Aiova, të SHBA-ve.

Komandanti i KFT-së, gjeneral Rrahman Rama, kthehet nga SHBA-ja pas një trajnimi gjashtëmujor

Zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, filloi punën dhe detyrat e përditshme pas përfundimit të trajnimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjeneralmajor Rrahman Rama ka përfunduar me sukses trajnimin gjashtëmujor, të filluar në shkurt të këtij viti, në bazën ushtarake të Forcave Ajrore në San Antonio të shtetit Teksas, në SHBA.

Pas një periudhe gjashtëmujore larg ushtarëve dhe oficerëve të FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, pas kthimit, është takuar me stafin e KFT-së, ku është njoftuar me zhvillimet në Komandën e Forcave Tokësore dhe njësitë e saj, përgjatë kohës sa ka qëndruar në trajnim, në Amerikë. Gjeneral Rrahman Rama ka theksuar se trajnimi i tij, në SHBA, ishte me mjaft interes dhe i rëndësisë së madhe. Po ashtu vëmendje të veçantë i ka kushtuar bashkëpunimit të FSK-së me SHBA-në dhe rolin që kanë SHBA-të në zhvillimin e FSK-së.



FSK-ja mbajti ceremoni lamtumirëse për komandantin e KFOR-it, gjeneralin Erhard Drews

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka organizua një ceremoni lamtumirëse për komandantin e KFOR-it, gjeneralin Erhard Drews, para se të largohet nga Kosova.



Komandanti i KFOR-it gjenerali Erhard Drews u prit nga ministri i MFSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministrat: Shemsi Veseli, Bejtush Gashi dhe Sllavisha Filipoviq, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Syla, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së, përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të FSK-së të Kuvendit të Kosovës të kryesuar nga Ahmet Isufi, përfaqësuesit e KFOR-it, këshilltarë të Ekipit Ushtarak Këshillues të NATO-s në FSK, si dhe atashetë ushtarakë të akreditуar në Kosovë.

Komandanti i KFOR-it u prit me nderime ushtarake nga njësia ceremoniale dhe kuadratet e FSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati e ka dekoruar komandantin e KFOR-it, gjeneralin Drews, me medaljen "Arritje e dalluar" me motivacionin për performancë të shkëlqyeshme gjatë kryerjes së detyrës ushtarake si komandant i KFOR-it dhe për mbështetje të jashtëzakonshme ndaj FSK-së"

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në ceremoninë lamtumirëse të organizuar nga FSK-ja, mbajti fjalën e rastit, ku, pos tjerash, tha:

" Jemi tubuar në këtë ceremoni lamtumirëse me rastin e kryerjes së detyrës së komandantit të KFOR-it, gjeneralit Drews.

Që nga themelimi FSK-ja ka pas mbështetjen e fuqishme dhe të pa rezervë të KFOR-it dhe ky bashkëpunim ka vazhduar gjatë tërë procesit të ngritjes dhe trajnimit të FSK-së.

I nderuar gjeneral Drews!

Gjatë mandatit Tuaj, ju jeni angazhuar me përkushtim të lartë për krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës. Prania Juaj në ushtrimet fushore të FSK-së ka qenë inspirim për realizimin profesional të ushtrimeve tona. Puna Juaj në kuadër të bashkëpunimit ka bërë avancime të dukshme në FSK dhe falë këtij bashkëpunimi, sot, FSK-ja është shumë më e përgatitur se para një viti.Ju në cilësinë e komandantit të KFOR-it i keni raportuar NATO-s dhe Brukselit, për plotësimin e kapaciteteve operacionale të FSK-së. Ju keni vlerësuar realisht ngritjen, zhvillimin dhe nivelin e kapaciteteve operuese e profesionale të FSK-së.

Ju i keni besuar FSK-së shumë detyra profesionale, të cilat FSK-ja, sot, po i kryen me sukses dhe përkushtim. Në zhvillimin e bashkëpunimit civil-ushtarak, Ju keni bërë çdo gjë që të ndihmohet FSK-ja, t'i jepet mundësia që ajo të marrë pjesë në rindërtimin e jetës dhe vendit. Ky bashkëpunim e ka forcuar besimin mes dy institucioneve tona dhe na ka ndihmuar në rrugën tonë drejt plotësimit të standardeve dhe ngritjes së kapaciteteve të plota operacionale.

Edhe pse jemi dy struktura të ndryshme dhe të pavarura, është e qartë se FSK-në dhe KFOR-in i bashkon qëllimi i njëjtë: Të ndërtojmë paqen dhe sigurinë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Të nderuar miq!

Siguria e qëndrueshme është objektivi më i rëndësishëm për shtetin e Kosovës dhe FSK-në, si kontribut dhe objektiv i përbashkët i shteteve të rajonit dhe më gjerë.

FSK-ja e ngritur me një strukturë profesionale dhe sipas standarde të avancuara të NATO-s, do të jetë kontribues aktiv, në funksion të paqes dhe të zhvillimit demokratik të Kosovës, duke e shndërruar Kosovën nga konsumues në kontribuues të paqes.

Prandaj, Bashkësia Ndërkombëtare, NATO dhe KFOR-i, duhet ta konsiderojnë sukses të vërtetë të tyre, ndërtimin e kapaciteteve të plota të FSK-së. Duhet ta vlerësojmë si histori të suksesit tonë të përbashkët. FSK-ja ka treguar pjekuri dhe profesionalizëm duke i ndihmuar të gjithë qytetarët e Kosovës, gjë që e ka rritë shumë besimin tonë si institucion tek publiku vendorë dhe miqtë tanë ndërkombëtarë.

Shumë i nderuar gjeneral Drews!

Ju siguroj se, ne,do të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim me të gjitha energjitë që kemi, së bashku edhe me pasardhësin Tuaj.

Të jeni të bindur se përpjekjet Tuaja, kanë qenë produktive dhe ju premtoj se FSK-ja, do të jetë gjithmonë e përkushtuar për t'i kontribuar paqes dhe stabilitetit.

Duke ju uruar gjithë të mirat në jetë dhe suksese të reja në karrierën tuaj ushtarake, Ju siguroj se as Ju e as puna Juaj nuk do të harrohen.

Edhe një herë suksese dhe faleminderit".

Fjala e komandanti të KFOR-it, gjeneralit Drews

Ju do t'i vendosni standardet për të ardhmen e FSK-së

"Është nder i madh për mua të pranoj këtë medalje sot dhe dëshiroj të ju falënderoj juve për konsideratën e lartë ndaj meje. Këtë dhuratë që po ma jepni sot, e pranoj me plot respekt në emër të ushtarëve të mi që kanë punuar pa u lodhur për Kosovën. Si komandant i KFOR-it, jam i bekuar që kam pasur nderin dhe privilegjin të udhëheq një forcë profesionale dhe të aftë.

Që nga fillimi i vitit 2009, FSK-ja vazhdimisht ka përparuar, duke zgjedhur dhe trajnuar individë cilësorë nga kultura të ndryshme. Dhe sot, qëndron e gatshme për të përmbushur misionin duke reaguar shpejtë dhe duke i ndihmuar autoritetet civile në katastrofat natyrore apo në emergjenca tjera.

FSK-ja ka vazhduar ta forcojë reputacionin e saj si një forcë profesionale përmes udhëheqjes, standardeve të larta dhe trajnimeve cilësore, që e kanë ndërtuar këtë forcë të jashtëzakonshme që e shohim këtu. Ju përgëzoj të gjithëve për një punë të kryer mirë dhe puna juaj drejtpërdrejt ka efekt në respektimin e



Kosovës:

Gjenerali Drews, më tej, shtoi: Të gjithë ju bartni një përgjegjësi të rëndë si pjesëtarët e parë që po i ndërtoni themelet e forta për të ardhmen e FSK-së e që gjithsesi do të formoni të ardhmen e Kosovës për gjeneratat që do të vijnë.

Nga perspektiva ime, Kosova ka bërë arritje të mëdha në përmirësimin e jetës së qytetarëve të saj dhe FSK-ja ka qenë pjesë e këtij përparimi. Edhe pse ka shumë ngjarje pozitive, njëra prej tyre mbetet e veçantë në mendjen time dhe që gjithmonë do ta kujtoj, ka qenë intervenimi i FSK-së, në Restelicë.

Ju keni zgjedhur një rrugë të shërbimit publik dhe gjatë shërbimit tuaj, do t'i vendosni standardet për të ardhmen e FSK-së. Vendosni standarde më të larta dhe bëni që veprimet e juaja të formësojnë reputacionin tuaj dhe të FSK-së.



Pritje në MFSK e ambasadores së Turqisë dhe këshilltarit ushtarak kolonel Yucel Keles

Ministri i MFSK-së Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati kanë pritë në vizita të ndara lamtumirëse, në Ministrinë e FSK-së, në përfundim të mandatit, këshilltarin ushtarak të ministrit dhe komandantit të FSK-së, kolonelin e Ushtrisë së Turqisë Yucel Keles të shoqëruar nga ambasadorja e Turqisë Songul Ozan.

Me këtë rast, ministri dhe komandanti i FSK-së, kanë vlerësua lartë bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes së Turqisë dhe Ushtrinë e Turqisë, duke falënderuar shtetin turk, për bashkëpunimin e deritanishëm si dhe gatishmërinë për të thelluar edhe më shumë këtë bashkëpunim.

Ministri Agim Çeku, në fund, e ka dekorua atasheun ushtarak turk, Yucel Keles me medaljen "Për shërbim të merituar". Ndërsa, komandanti i FSK-së gjeneral Kadri Kastrati, atasheut ushtarak turk i ka dhënë medaljen, për "Arritje të jashtëzakonshme".

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

U mbajt Konferenca për Programin Shtetëror të Bashkëpunimit Ajovë - Kosovë

Në shtetin Ajova të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për tri ditë me radhë është mbajt Konferenca për Programin Shtetëror të Bashkëpunimit ndërmjet shtetit të Aiovës dhe Kosovës.



Në konferencë kanë marrë pjesë ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, oficerë dhe zyrtarë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së, zëvendëskryeministri dhe ministri i Ministrisë së Drejtësisë Hajredin Kuçi, ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, ambasadori i Kosovës në Uashington Akan Ismaili, atasheu i sigurisë pranë ambasadës së Republikës së Kosovës në Uashington gjeneral brigade Xhavit Gashi, atasheu ushtarak i SHBA-ve në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, zyrtarë të lartë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë si edhe afaristë e përfaqësues të shoqërisë civile nga Republika e Kosovës.
Konferenca treditore i ka filluar punimet më 15 gusht 2012 dhe i ka përfunduar më 17 gusht 2012. Konferenca është përqendruar në planet dhe synimet për të ardhmen në kuadër të Programit Shtetëror të Partneritetit Ajovë-Kosovë. Përfaqësues të qeverisë dhe udhëheqës të sektorit privat nga Kosova dhe Ajova, gjithashtu, kanë marrë pjesë dhe kanë diskutuar për mënyrat e bashkëpunimit konkret dhe intensiv.
Punimet e Konferencës i shpalli të hapura komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneral-major Timothy Orr, i cili tha: "Është e lehtë për të zhvilluar pjesën ushtarake të misionit-një urdhër i lëshuar dhe zbatohet në praktikë, ndërsa zhvillimi i marrëdhënieve civile është sfidë tjetër e rëndësishme. Është e rëndësishme për të ndërtuar këto marrëdhënie. Kjo është ajo që ne jemi duke bërë këtu. Këto marrëdhënie mund të zhvillohen duke takuar bashkë liderë të ndryshëm nga Kosova dhe Ajova".
Ndërsa zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës të Kosovës dhe ministër i Ministrisë së Drejtësisë Hajredin Kuçi bëri një prezantim me temën: "Republika e Kosovës sot dhe në të ardhmen", e cila zgjoi interesim të madh tek të pranishmit, ku u fokusua në situatën politike, kushtet dhe mundësitë ligjore që ofron Kosova për investime si edhe falënderoi shtetin e Ajovës e në veçanti Gardën Kombëtare të Ajovës, me të cilën Forca e Sigurisë së Kosovës ka marrëveshje bashkëpunimi që nga marsi i vitit 2011.
Në punimet e ditës së parë mori pjesë edhe guvernatori i shtetit të Ajovës, Terry Branstad. Zotëri Terry Branstad, pasi përshëndeti pjesëmarrësit në konferencë tha; "Ndoshta mënyra më e mirë për të bërë këto lidhje do të përqendrohet në pikat e forta të ngjashme të dy shteteve, shtetit të Ajovës dhe të Kosovës. "Ne duam të bëjmë çdo gjë që është e mundur që marrëdhëniet në mes të Ajovës dhe Kosovës të zhvillohen edhe më tutje" tha guvernatori i Ajovës, z. Branstad.
Ndërsa ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara, Akan Ismaili, tha se takimet e tilla, janë një mundësi e mirë për ndërtimin e frymës bashkëpunuese. Ne mund të ndajmë me ju sfidat tona dhe planet për të ardhmen dhe të shohim se si mund të punojmë së bashku për të arritur këto qëllime," tha Ismaili.

Ministri Çeku: Sukseset dhe sfidat e FSK-së drejt zhvillimit të saj

Në ditën e dytë të zhvillimit të punimeve të Konferencës për Programin Shtetëror të Bashkëpunimit Ajovë-Kosovë, u paraqitën ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me temat: themelimi, suksesi dhe sfidat e FSK-së.



Ministri Agim Çeku, në paraqitjen e tij, foli për aspektin politik të themelimit të FSK-së, zhvillimit të saj dhe objektivave të Ministrisë dhe Qeverisë për zhvillimin dhe modernizimin e strukturës së Forcës së Sigurisë të Kosovës. Ministri Çeku me këtë rast përmendi edhe faktin se misioni i FSK-së është i përcaktuar me pakon e Ahtisarit dhe se më deklarimin e përmbushjes së kapaciteteve për FSK-në, do të krijohen mundësi për më shumë kompetenca dhe hapje të mundësive për integrime rajonale si dhe integrime në NATO.
Më tej, ministri i MFSK-së Agim Çeku ka vlerësuar shumë lartë angazhimin e Gardës Kombëtare të Ajovës në funksion të mbështetjes së ofruar për FSK-në. Ai tha se që nga marsi i vitit 2011, kur FSK-ja dhe Garda Kombëtare e Ajovës kanë nënshkruar Programin e Partneritetit, rezultatet janë të dukshme dhe shumë konkrete. Ministri Çeku nga ana e tij shpalosi idenë për zhvillimin e FSK-së në një forcë moderne, efektive dhe profesionale. Në fund ministri Çeku, falënderoj posaçërisht gjeneralmajorin Timoti Orr, për angazhimin e tij, si komandant i Gardës Kombëtare të Ajovës për mbështetjen e gjithanshme që ka bërë deri më tani, për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në fjalën e tij, shpalosi të arriturat e FSK-së që nga viti 2009, vit kur edhe është themeluar FSK-ja. Po ashtu gjeneral Kastrati foli konkretisht për fushat e bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare, për mbështetjen që Garda e Ajovës, i ka ofruar FSK-së. Gjeneral Kastrati, më tej shtoi, se:"Aktualisht në FSK janë duke instruktuar disa oficerë të Ajovës, sidomos në zhvillimin e Korit të Nënoficerëve si shtylla e çdo organizimi ushtarak. Ai shprehu përkushtimin e tij, për vazhdimin e bashkëpunimit duke ofruar edhe fusha konkrete të identifikuara të cilat janë të vendosura si synime të tij, si komandant i FSK-së.
Në konferencë me një ligjëratë u paraqitë edhe ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, i cili u fokusua mbi çështje të sigurisë dhe funksionimit të ligjit në Kosovë.
Besa Kabashi Ramaj, këshilltare e lartë e ministrit të MFSK-së Agim Çeku, foli për temën: Rishikimi i Sektorit Strategjik të Sigurisë.
Temat e ligjëruara nga udhëheqësit kryesorë të institucioneve të sigurisë së Kosovës, zgjuan interesimin e të pranishmëve të cilët edhe paraqiten një varg pyetjesh, gjithsesi për të fituar një pasqyrë të qartë të gjendjes në Kosovë.
Në këtë konferencë morën pjesë edhe disa ministra, qeveritarë dhe zyrtarë të disa ministrive të Qeverisë së Kosovës si ministri i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Blerand Stavileci et:j.

Përfundon me sukses ushtrimi i FSK-së "Reagim ndaj krizave" në Krivollak të Maqedonisë

Shemsi Veseli: FSK-ja është e përgatitur profesionalisht për reagim ndaj krizave



Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Shemsi Veseli, nga Kazerma e FSK-së "New Born", në Gjilan, përshëndeti të gjithë oficerët dhe ushtarët e FSK-së, të KFOR-it, të NATO-s dhe të Ajovës, para nisjes së tij në ushtrimin ndërkombëtar "Reagim ndaj krizave" në Krivollak të Maqedonisë. "Sot është një ditë e shënuar për MFSK-në, për bashkëpunimin rajonal mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, gjegjësisht midis Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Dislokimi i kontingjentit të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe testimi i gatishmërisë së dislokimit të saj është një sukses i madh i FSK-së.

Për këtë, falënderoj ekipin mentorues të KFOR-it, përfaqësuesit e Ajovës, që njëherësh janë partneri ynë më i fuqishëm."

Në fund zëvendësministri Veseli kërkoi përkushtim, disiplinë dhe profesionalizëm. "Kjo asnjëherë nuk i ka munguar FSK-së. Me këtë tregoni se FSK-ja i ka plotësuar të gjitha kapacitetet e saj operacionale dhe është e gatshme që të marrë pjesë në dislokime; në misione paqeruajtëse kudo në botë".

Forca e Sigurisë së Kosovës në përmbushje të misionit të saj aktual kushtetues, në përballje me sfidat dhe rreziqet e mundshme natyrore që mund t'i kanosen vendit tonë, por edhe vendeve të rajonit, më datë 27 gusht 2012, është dislokuar në Republikën e Maqedonisë me një kontingjent të madhësisë së një kompanie prej 120 pjesëtarësh të stërvitur dhe të pajisur për Reagim ndaj Krizave. FSK -ja për realizimin e këtij operacion mjaft kompleks ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme.

Skenari i ushtrimit për "Reagim ndaj krizave" ishte: Instituti Sizmologjik i Republikës së Maqedonisë, ka njoftuar se Republikën e Maqedonisë e ka goditur një tërmet prej 6.7 shkallë të Rihterit me epiqendër në rajonin e Krivollakut në Negotin. Si pasojë e tërmetit, njoftohet për shumë objekte të rrënuara, njerëz të ngujuar nën gërmadha, shkatërrim të infrastrukturës rrugore, energjetike, ujësjellësit, nyejve të komunikimit dhe rrjedhjeve të materieve të rrezikshme, aksidente në komunikacion etj.

Republika e Maqedonisë ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme dhe ka kërkuar ndihmë nga vendet e rajonit. Ndihmës i është përgjigjur edhe Republika e Kosovës, duke i ofruar një kontingjent me njësi të specializuara të Kërkim-Shpëtimit Urban dhe MKAB-së, për përballje me materiet e rrezikshme. Po ashtu Republikës së Maqedonisë për zhvillimin e këtij operacioni i është ofruar ndihmë edhe me ekipe mjekësore, të komunikimit dhe me një kontingjent të Policisë së Forcës.

Në mbështetje të autoriteteve maqedonase për zhvillimin e operacioneve emergjente, pas tërmetit që ka goditur këtë vend, kontingjenti i FSK-së, duke shfrytëzuar rrugët tokësore dhe mjetet vetjake të transportit është dislokuar në territorin e Republikës së Maqedonisë, në Krivollak.

I tërë operacioni është zhvilluar në dy faza: në fazën e planifikimit dhe në fazën e realizimit të operacionit.

Komanda e Forcës Tokësore të FSK-së në këtë operacion i ka angazhuar njësitet e specializuara Ky është dislokimi i parë i FSK-së, jashtë vendit, për këso lloj ushtrimesh. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në bazë të planeve, angazhimeve si dhe vizionit për bashkëpunim në të ardhmen, ka dislokuar një kontingjent në Krivollak të Republikës së Maqedonisë, në mënyrë që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi si forcë e përbashkët të jetë udhërrëfyes për operacione të mundshme në të ardhmen. FSK-ja tregoi se është e përgatitur me personel dhe pajisje të nevojshme për të zhvilluar këso lloj ushtrimesh me karakter ndërkombëtarë për "Reagim ndaj krizave".

Këtë ushtrim të kontingjentit të FSK-së, në Krivollak, e kanë përcjellë: ministri Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati, gjeneralët Zymer Halimi dhe Nazmi Brahimaj, oficerë të KFOR-it, pjesëtarë të Gardës Nacionale të Ajovës, këshilltarë të Ekipit Këshillues të NATO-s etj.



Fillimisht, ministrin dhe komandantin e FSK-së, për rrjedhat e ushtrimit përmes një paraqitje të shkurtër (brifingu) i njoftuan shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel Naim Haziri dhe komandanti i kontingjentit, major Berat Shala.

Pastaj, ministri, komandanti dhe delegacioni i FSK-së, përcollën nga afër ushtrimet në terren të Njësitit të Ndërlidhjes, MKAB-së dhe të Kërkim-Shpëtimit Urban.

Ministri i FSK-së Agim Çeku u shpreh i kënaqur për zhvillimin me sukses të ushtrimit. Ai pasi përshëndeti të gjithë oficerët dhe ushtarët, ka vlerësuar lartë edhe punën e pjesëtarëve të FSK-së të treguar në këto ushtrime, e cilat ka të bëjë kryesisht me operacione të kërkim-shpëtimit, MKAB-së, komunikimit, deminimit etj, në situata të jashtëzakonshme si në fatkeqësi natyrore dhe operacione komunikuese.

Ministri Agim Çeku, ka thënë se një ndër objektivat kryesore të FSK-së, është që FSK-ja të bëhet forcë e zbarkueshme jashtë vendit. "Qëllimi i këtij ushtrimi është që t'i ushtrojmë, por edhe t'i zbatojmë në praktikë të gjitha procedurat e dërgimit të forcave jashtë vendit, në radhë të parë procedurat e standardeve operative, pastaj edhe proceduarat administrative dhe ato ligjore që duhet t'i ndjekim për të marrë një vendim, në kuadër të institucioneve tona, si dhe procedurat që duhet t'i ndjekim me kalimin e kufirit dhe qëndrimin në vendin fqinjë. Të gjitha këto procedura, gjatë këtij ushtrimi, janë zbatuar në praktik dhe mund të them se është arritur plotësisht qëllimi i këtij ushtrimi.

Ministri Çeku në fund, tha: qëllim tjetër i këtij ushtrimi ka qenë edhe forcimi i marrëdhënieve në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati në fjalën e tij tha: kjo është një përvojë e mirë për pjesëtarët e FSK-së dhe, sipas tij objektivi i këtij ushtrimi është realizuar ashtu siç ishte planifikuar. Ne, gjatë këtij ushtrimi i kemi realizuar të gjitha proceduarat standarde të mundshme si pikë e komunikimit, në mes Maqedonisë-Tiranës dhe Prishtinës.

"Qëllimi i FSK-së është arritur për arsye se kjo kompani i ka ushtruar të gjitha procedurat, standardet nga mobilizimi, planifikimi, kolona deri këtu, zbarkimi, ngritja e kampit dhe pas përfundimit të ushtrimit, urdhri për kthim në kazerma. Qëllimi tjetër ka qenë komunikimi strategjik, që ne e kemi arritur dhe i kemi vendosur pikat e komunikimit këtu në Krivollak, në Tiranë dhe në Prishtinë. Ky komunikim ka rrjedhur sipas procedurave pa pengesa dhe kjo është një e arritur shumë e madhe, që unë e vlerësoj si komandant i FSK-së", ka thënë në fund gjeneral Kastrati.

Pjesë e ushtrimit të FSK-së kanë qenë edhe gjashtë pjesëtarë të Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët kanë qenë së bashku me pjesëtarët e FSK-së, në realizimin e këtij ushtrimi. Kontingjenti i FSK-së pas përfundimit me sukses të ushtrimit treditor "Reagim ndaj krizave" është kthyer në Kosovë, për të vazhduar me punë dhe aktivitete të përditshme .

Pjesëtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët e kanë përcjellë ushtrimin që nga fillimi e deri në fund, janë shprehur të kënaqur me ecurinë e njësive të specializuara të FSK-së.







Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, vizitoi deminierët e FSK-së në Koshare

FSK-ja pastron këtë vit mbi 70 mijë metra katrorë sipërfaqe të minuara



Ekipi i deminierëve në Koshare ka pastruar mbi 20 mijë m² dhe ka shkatërrua 29 mjete të pashpërthyera, si: mina, granata dore, eksploziv, projektil etj.
Për të përcjellë nga afër aktivitetin e ekipit të deminierëve të FSK-së, në Koshare, qëndroi komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku më zv. ambasadorin e Britanisë së Madhe Joe Preston, atasheun ushtarak të SHBA-së, ku morën pjesë edhe oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, NATO-s etj.
Gjenerallejtënant Kadri Kastarti dhe zv. ambasadori i Britanisë së Madhe Joe Preston, kanë përshëndetur ekipin e deminierëve për punën e madhe që po bëjnë në pastrimin e minave dhe të mjeteve të tjera të pashpërthyera.
Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës Kadri Kastrati, ka me pasoja për tërë jetën.
Gjeneral Kastrati është shprehur i lumtur dhe se ndihet tejet krenar me punën e deminierëve dhe në përgjithësi me profesionalizmin e tyre, ku vetëm falë këtij profesionalizimi, deri më tani asnjë pjesëtarë i FSK-së nuk ka pësuar as gërvishtjen më të vogël.
Në fund gjeneral Kadri Kastrati kërkoi nga ekipi i deminimit që edhe më tutje të punojnë me përkushtim dhe me profesionalizëm, që sa më parë ta bëjnë pastrimin e të gjitha mjeteve të pashpërthyera në Kosovë, duke e bërë kështu jetën e qytetarëve më të qetë dhe më të sigurt, kur dihet se "Ky vend ka qenë një vij frontale ku është luftuar me forcat serbe, të cilat kanë lënë shumë mina që paraqesin rrezik të madh për të gjithë banorët e Kosovës"
Kompania e Deminimit e FSK-së, gjatë këtij viti ka arrit të bëjë pastrimin e mbi 70 mijë m² të territorit të Kosovës dhe ka shkatërruar mbi 200 predha të llojeve të ndryshme, si: granata dore, mortaja, raketa, bomba-kasetë, mina të ndryshme etj.
Kompania e Deminimti po vazhdon aktivitetin e saj në këto lokalitete: Në Hajvali, Komuna e Prishtinës, në Harilaq, Komuna e Fushë-Kosovës, në Ferizaj, si dhe të fushëbetejat e Koshares, Belincës etj.



Delegacioni i Akademisë për Paqe dhe Siguri në Evropë i Austrisë vizitoi FSK-në

Një delegacion i gjerë i Akademisë për Paqe dhe Siguri në Evropë i Austrisë i prirë nga ING.MMag Gunther J. Rozenitz, zhvilloi një vizitë në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me ç'rast u priten nga Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe shefi i shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri.
Gjeneral Kastrati për delegacionin austriak bëri një prezantim të historikut të ngritjes dhe zhvillimit të Forcës së Sigurisë për këto vite që nga themelimi e deri më tani. Po ashtu komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me theks te veçantë u ndalë në arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale, strukturën e FSK-së, detyrat si edhe bashkëpunimin ne vendet e rajonit.
Interesimi i delegacionit austriak ishte edhe mbi të ardhmen e FSK-së si edhe perspektiva e FSK-së, për të cilën gjeneral Kastrati foli me optimizëm në bazë të parametrave të vendosur dhe objektivave, si edhe krahas zhvillimeve politike në prag të



përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë, si edhe pas rishikimit strategjik te sektorit te sigurisë, priten detyra shtesë si edhe ndryshim i misionit të Forcës.
Akademia për Paqe dhe Siguri në Evropë ka anëtarësi me profil ushtarak, shumica prej aktivistëve dhe veprimtarëve të saj janë me karrierë të oficerëve, të cilët e njohin mirë aspektin e sigurisë, jo vetëm në Austri por edhe në rajonin e Ballkanit e më gjerë në Evropë. Në koordinim të vizitës së sotme një kontribut ka dhënë edhe bashkatdhetari ynë, Miftar Kastrati, udhëheqës i Institutit për Integrime, i cili ka iniciuar takimin dhe ka në plan gjetjen e fushave me të cilat mund të bashkëpunohet në të ardhmen

Atasheu i ri ushtarak i Holandës u prit nga zëvendësministri Shemsi Veseli dhe gjenerali Gëzim Hazrolli

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Shemsi Veseli dhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli kanë pritë në takime të ndara, atasheun ushtarak në largim të Holandës, nënkolonel Ton Koedam dhe atasheun e ri, nënkolonel Jan Williem de Wolt.
Vizita e atasheut të ri ushtarak të Holandës, nënkolonelit Jan Williem de Wolt kishte për qëllim njohjen me punën e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë të Kosovës.
Me këtë rast, zëvendësministri Veseli dhe gjeneral Hazrolli duke i uruar mirëseardhje në detyrë dhe duke i ofruar bashkëpunim atasheut të ri, e njoftuan atë edhe me të arriturat e FSK-së dhe me objektivat e saj për të ardhmen. Ata po ashtu falënderuan atasheun në largim, nënkolonel Ton Koedam, për bashkëpunimin e pakursyer që ka treguar gjatë detyrës së tij me FSK-në, si dhe për realizimin e shumë projekteve në Kosovë.



Zvëndësministri i Punëve të Jashtme të Turqisë vizitoi Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Zvendësministri për ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës Bejtush Gashi priti në ambientët e kësaj ministrie ambasadorin Naci Koru zëvëndësminstërr i Punëve të Jashtme të Turqisë si dhe ambasadoren e Turqisë në Kosovë Songul Ozan.
Gjatë këtij takimi zvëndësministri Gashi e njoftoi zvendësministrin Koru për arritjet e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe punen e vazhdushme të MFSK-së që Forca të arrijë që ti pranohen dhe miratohen Kapacitetet e Plota Operacionale. Po ashtu zëvendësministri i MFSK-së Bejtush Gashi e falëndëroi zotëri Koru për mbështetjen e vazhdueshme për ministrin e FSK-së në të gjitha aspektet, duke përmendur kështu projektet dhe trajnimet e ndryshme që pjestarët e ushtrisë së Turqisë janë duke i zhvilluar për pjestarët e FSK-së.
Ndërkaq zvendësminstri Koru tha se është jashtëzakonisht i knaqur me të arrituart e FSK-së dhe se Turqia do të vazhdojë edhe më tutje thellimin e këtij bashkëpunimi si në aspektin politik po ashtu edhe në atë ushtarak.
Pjesëmarrës të këtij takimi ishin edhe drejtori i Departamentit për Politika dhe Plane, Haxhi Shala, drejtori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, kolonel Ilir Qeriqi, si dhe përfaqësues të ambasadës Turke në Kosovë Ahnek Dereli, Ulvi Darendeli dhe Nora Cecelia.



Dy kadete të FSK-së shkollohen në Akademinë Mbretërore Ushtarake-SANDHURST

Dy kadete të Forcës së Sigurisë së Kosovës po marrin pjesë në një shkollim njëvjeçar në Akademinë Ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar SANDHURST. Përzgjedhjen e kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka bërë Ambasada Britanike. Kadetet e përzgjedhura janë; nëntoger Manushaqe Nura dhe nëntoger Mimoza Budeci, të cilat fillimisht do të kalojnë në një trajnimin trejavor, në fazën paraprake, në kursin e gjuhës angleze në Akademinë Mbretërore Ushtarake; (në Shkollën e Gjuhëve të Mbrojtjes, Beaconsfield), pastaj për njëmbëdhjetë muaj do të ndjekin trajnimin në Akademinë Ushtarake Mbretërore, Sandhurst, për oficer, ku do të qëndrojnë deri më 8 shtator 2013. Ky trajnim është realizuar me ftesë formale nga Qeveria e Britanisë së Bashkuar dhe kjo do të jetë hera e parë, që Kosova ka dërguar dy kadete në Akademinë Ushtarake-Sandhurst.
Që nga viti 2009, qeveria britanike ka financuar pjesëmarrjen e kadeteve të Forcës së Sigurisë të Kosovës në kurset njëvjeçare në kuadër të trajnimit për oficer në Akademinë Mbretërore Ushtarake, Sandhurst. Çdo kurs zakonisht kushton rreth 60.000 funta për kadet. Akademia Mbretërore Ushtarake-Sandhurst është një nga akademitë më të vjetra ushtarake dhe më prestigjioze në botë. Ajo çdo vit përgatitë mbi 600 oficerë të rinj, për



ushtrinë britanike, ku së bashku e kryejnë edhe një numër i vogël i studentëve të shteteve të ndryshme të botës, të cilët paraprakisht kanë kaluar nëpër fazën seleksionuese që të jenë pjesë e Akademisë Ushtarake.
Konkurrenca për të gjitha vendet është jashtëzakonisht e madhe dhe regjimi rigoroz i trajnimit do të thotë se jo të gjithë do të diplomojnë me sukses.
Për këtë arsye, vetë përzgjedhja e kadeteve të FSK-së është një arritje e konsiderueshme jo vetëm për kadetët, por edhe për FSK-në.
Të dy kadetet e FSK-së, Nura dhe Budeci që nga 18 gushti kanë filluar shkollimin në Akademinë Ushtarake në Mbretërinë e Bashkuar.

Në Zhilivodë të Vushtrrisë nuk ka mbetje mortore

FSK-ja ka punuar në këtë projekt humanitar për tri vite, në tri faza, ku ka gërmuar mbi 86625 metra kub dhe, dhe ka kryer mbi 9757 orë pune. Qëllimi i saj ka qenë që me personel dhe mjete të tjera teknike të realizoj këtë projekt, për gjetjen e mbetjeve mortore.
Në përmbyllje të gërmimeve, sot morën pjesë përfaqësues të EULEX-it, të Qeverisë së Kosovës, Komisionit për Personat e Pagjetur, përfaqësues të Komisioneve përkatëse nga Serbia, përfaqësues të FSK-së, etj.
Kryetari i Komisionit për Personat e Pagjetur, Preng Gjetaj, tha se kemi punuar dhe gërmuar më shumës se tri vite, për zbulimin e 1300 personave të pagjeturzhdukur, por sot, po e përmbyllim këtë projekt, pa rezultate, sepse nuk ka pasur mbetje mortore. Zotëri Gjetaj në emër të Qeverisë së Kosovës falënderoi Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) për punët e kryera, departamentin e Mjekësisë Ligjore, EULEX-in dhe ambasadën e Norvegjisë e cila e ka mbështet projektin e Zhilivodës.
Projekti i gërmimit-hulumtimit në Zhilivodë ka qenë njëri ndër projektet më transparente deri më tani, ku të gjithë kanë pasur mundësi të marrin pjesë në përcjelljen e punimeve gjatë hulumtimit në këtë lokalitet, kjo ka ndodhur sepse Qeveria e



Kosovës është shumë e interesuar për zbardhjen e të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me personat e zhdukur gjatë luftës, përfundoi fjalën e tij zotëri Gjetaj.
"FSK-ja falë bashkëpunimit të mirë me Institucionet vendore, EULEX-in dhe të tjerë, ka arrit që të gërmoj mbi 86625 metra kub dhe, kanë punuar mbi 9757 orë pune, në këtë lokalitet dhe sot, po i përfundojnë gërmimet. Është për ta përshëndetur punën e pjesëtarëve të FSK-së, të cilët edhe përkundër thellësisë mbi 30 metra nën tokë, kanë gërmuar pa pasur as më të voglin problem dhe kjo flet për profesionalizmin e pjesëtarëve të Xhenios të FSK-së" tha në fund gjeneralbrigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione të FSK-së.
Ndërsa, Krasimir Nikoolaev, ushtrues i detyrës së bashkëkryesuesit (EULEX), në Departamentin e Mjekësisë Ligjore, tha se edhe përkundër gërmimeve nën 30 metra thellësi, nuk ka pasur mbetje mortore. Ai ka falënderuar njësitin e Xhenios të FSK-së, për punën profesionale të saj. "Hapësira që ishte lëndë e interesimit dhe e cila ishte përcaktuar në urdhrin e gjykatës përfshinte rreth shtatë mijë metra katrorë dhe përbëhej prej dymbëdhjetë minierave të thëngjillit të lidhura me tunele. Ato janë gërmuar të gjitha. Aty nuk u gjetën mbetje mortore të njerëzve", tha në fund Krassimir Nikolov.
Pasi ka falënderuar FSK-në, për punën profesionale dhe këmbëngulëse për gjetjen e personave të zhdukur, Arsim Gërxhaliu, drejtor i Departamentit të Mjekësisë Ligjore, tha se ne jemi shumë të interesuar për zbardhjen e fatit të gjithë personave të pagjetur, dëshmon edhe kjo sot, ku për një informatë jo të besueshme kemi bërë një punë kaq të madhe, qe tri vite.



FSK-ja intervenon për shuarjen e zjarreve në Kosovë

Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht njësitet e specializuara të saj, gjatë ditëve të fundit kanë intervenuar në shumë vende në shuarjen e zjarreve që ka kapluar lokalitet si pasojë e temperaturave të larta dhe të faktorëve të tjerë.
Njësitet e zjarrëfikjes kanë intervenuar me sukses në Deçan, Isniq, Korreticë, Cernushë (Mitrovicë) etj.
Njësitet profesionale të zjarrëfikjes të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) janë angazhuar me personel dhe makineri të rëndë në shuarjen e zjarreve që i kanë përfshirë shumë male në disa lokalitete.
Më 6 gusht, një njësit i FSK-së, me 8 pjesëtarë dhe me 2 automjete ka intervenuar në fshatin Korreticë të Epërme, në Komunën e Drenasit. Ndërsa, më 7 gusht njësitet e zjarrëfikjes së FSK-së, kanë intervenuar në Bjeshkët e Deçanit, me 35 pjesëtarë dhe me 4 automjete të ndara në dy skuadra:
Në fshatin Cernushë të Komunës së Mitrovicës, ka intervenuar Batalioni i Dytë i Brigadës për Reagimit të Shpejtë, më 13 pjesëtarë dhe 2 automjete. Gjithashtu, më 7 gusht ka intervenuar edhe një njësitë i Kompanisë së Zjarrëfikjes për shuarjen e zjarrit në varrezat e fshatit Isniq, Komuna e Deçanit, ku ishin të angazhuar 9 pjesëtarë edhe një automjet.
FSK-ja gjatë dy ditëve të fund ka angazhuar 106 pjesëtarë me gjithsej 15 automjete të rënda për shuarjen e zjarreve në Kosovë.
Forca e Sigurisë së Kosovës në raste emergjencash të shkaktuara nga zjarri, intervenon vetëm atëherë kur kapacitetet civile në nivel lokal dhe regjional nuk ia dalin ta sanojnë gjendjen dhe për këtë kërkojnë ndihmë, atëherë aktivizimi i FSK-së bëhet nëpërmjet Këshillit të Sigurisë së Kosovës me urdhër të Presidentit dhe Kryeministrit. FSK-ja, është reagues i parë në Deminim dhe Mbrojtje Kimike -Biologjike - Atomike(MKBAK).

FSK-ja përfundoi projektin humanitar në Nekoc të Drenasit

Njësia e Xhenios që vepron në kuadër të Brigadës së Mbështetjes Operacionale të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në organizim të Departamentit Civil-Ushtarak të MFSK-së, këto ditë ka realizuar edhe një projekt humanitar, në fshatin Nekoc të Drenasit, pastrimin e mbeturinave të ish-objektit të shkollës të demoluar gjatë luftës në Kosovë.
Njësia e Xhenios këtë projekt e ka filluar më 08 gushtë 2012 dhe e ka përfundua më 23 gusht 2012. Objekti ka pasur një sipërfaqe prej 780 m², ndërsa Njësia e Xhenios e FSK-së, ka pastruar mbi 170 kamionë me mbeturina, gjithsej 2066 m³.
Në përfundimin e punëve të projektit në fshatin Nekoc, ka qëndruar për një vizitë punë edhe komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO), kolonel Ilaz Dërguti me bashkëpunëtorë i cili ka përshëndetur pjesëtarët e Xhenios, të cilët me përkushtim janë angazhuar në realizimin e këtij projekti humanitar. Kolonel Dërguti ka premtuar se edhe në të ardhmen Kompania e Xhenios e FSK-së, që ai drejton, do të angazhohet në projekte humanitare, kudo në Kosovë, për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve tanë. Ai ka falënderuar pjesëtarët e xhenios për punën e palodhshme, si dhe drejtorin e shkollës dhe banorët e fshatit Nekoc, për bashkëpunim e mirë me FSK-në.



FSK-ja intervenoi edhe në Bjeshkët e Koritnikut

Gjeneral Kastrati: Njësitet e FSK-së po angazhohen me të gjitha kapacitetet profesionale në shuarjen e zjarreve

Njësitë e zjarrëfikjes dhe të deminimit të FSK-së, gjatë muajit gusht, kanë marrë pjesë në shumë aksione për fikjen e zjarreve dhe heqjen e mjeteve të pashpërthyera, si në malin Koritnik të Komunës së Dragashit, në Koshare etj.
Njësitë e FSK-së, me një numër të madh pjesëtarësh dhe me autocisterna e makina transportuese si dhe me pajisje personale dhe mjete profesionale kundër zjarrit, kanë vepruar në Malin e Koritnik të Komunës së Dragashit, ku me një angazhim maksimal dhe profesional kanë arritur ta lokalizojnë zjarrin, në këtë komunë. Në vendin e ngjarjes, për një vizitë pune, ka qëndruar edhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati për të parë nga afër aktivitetin e njësive të FSK-së si dhe për të bërë vlerësimin e punës dhe të gjendjes që po mbretëron në terren.
Komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati së bashku me kryetarin e Komunës së Dragashit, kanë vizituar vendin e ngjarjes, ku janë njoftuar për situatën e rëndë, si dhe për angazhimin maksimal dhe profesional të njësive të FSK-së, Situata raportohet të jetë tejet e rëndë, për shkak të rrezikut të shpërthimit të minave të mbetura nga lufta dhe rrezikut të shpërthimeve të tyre. Si pasojë e zjarrit ka pasur edhe shumë shpërthime të minave.
Kjo gjendje e bënë edhe më të vështirë punën duke pasur parasysh edhe mbrojtjen e jetës së pjesëtarëve të FSK-së dhe pjesëmarrësve tjerë në aksion.
Çdo ditë njësitë e FSK-së së bashku me njësitë e zjarrëfikjes civile dhe qytetarët janë duke vazhduar me përpjekje maksimale për të fikur zjarrin. Me gjithë situatën e krijuar në terren, FSK-ja ka arrit ta lokalizojë zjarrin në malet e Koritnikut.



FORCA JONË

* * * Viti I • Nr. 5 • Tetor 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

SHBA-të mbështesin integritetin e Kosovës



Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jakobson, gjatë takimit me ministrin Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastratin ka rikonfirmuar përkushtimin për ta ndihmuar integrimin e FSK-së në NATO.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, zonja Tracy Jacobson së bashku me atasheun ushtarak kolonelin James Kott kanë qëndruar për një vizitë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, ku janë pritë nga ministri i FSK-së Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati.
Kjo ishte vizita e parë e ambasadores Jacobson, në MFSK-së, qëkur e ka marrë detyrën e ambasadores së SHBA-ve, në Prishtinë.
Ministri Agim Çeku me këtë rast i ka uruar detyrën e re zonjës Tracy Jacobson dhe njëherësh përmes saj i ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për gjithë atë që kanë bërë për Kosovën dhe për FSK-në. Ministri Agim Çeku më pastaj e ka njoftuar ambasadoren Jacobson me të arriturat e FSK-së, plotësimin e kapaciteteve operacionale, trajnimet, shkollimin, bashkëpunim e përgjithshëm në rajon dhe në veçanti bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Gardën Kombëtare të Ajovës, si dhe objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të FSK-së për të ardhmen.
Në prononcimin para medieve, ministri Çeku, ka thënë: "Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë partneri ynë më i fuqishëm në ngritjen, ndërtimin dhe zhvillimin e FSK-së. Sukseset e shumta që ka arrit FSK-ja, në përmbushjen e shumë objektivave kishin qenë të pamundur pa mbështetjen, pa këshillat, pa ndihmën dhe pa përfshirjen e SHBA-ve.
Gjithashtu, SHBA-të janë mbështetësi më i fuqishëm në agjendën tonë të integrimit në NATO, të integrimit rajonal, si dhe të bashkëpunimit dypalësh me vendet e Evropës dhe SHBA-të".
Unë e shfrytëzova rastin, që ambasadoren e SHBA-ve, Tracey Jacobson ta falënderojë për ndihmën e Amerikës dhe e informova me të arriturat, objektivat, prioritetet, sfidat dhe me vizionin tonë që kemi për të ardhmen".
Unë kërkova mbështetje për arritjen e çdo objektivi, që ne e kemi dhe u sigurova nga ambasadorja Jacobson se përkrahja e SHBA-ve nuk do të mungojë, por do të shënojë rritje.
Ndërsa, ambasadorja Tracey Jacobson në fjalën e saj ndër të tjera tha: " Do të angazhohem që ta ndihmojmë FSK-në, në plotësimin e kapaciteteve në këto fusha: kërkim-shpëtim, zjarrëfikje, deminim dhe MKABK.
Ne, gjatë këtij viti kemi pasur 32 fusha trajnimi të përbashkëta, ndërsa gjatë vitit 2013 kemi planifikuar edhe 36 fusha të tjera bashkëpunimi. Jam shumë e bindur që FSK-ja do të jetë lider regjional në këto fusha, që kishte me qenë në interes të Kosovës dhe të fqinjëve të saj. Në fund, ambasadorja Jacobson premtoi vazhdimin e bashkëpunimit shumë të ngushtë edhe në të ardhmen me FSK-në.



Komandanti i FSK-së i raportoi presidentes së Republikës së Kosovës



Presidentja e Republikës së Kosovës zonja Atifete Jahjaga priti në takim të rregullt, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastratin, me të cilin biseduan për aktivitet e zhvilluara gjatë këtij muaji në FSK.
Gjeneral Kastrati e informoi gjerësisht presidenten Jahjaga lidhur me aktivitet e përgjithshme që po i realizon Forca e Sigurisë së Kosovës, për operacionet e deminimit, intervenimet e EOD-së, kërkim-shpëtimit, të MKABK-së etj. Theks të veçantë, gjeneral Kastrati i kushtoi ushtrimit të fundit të FSK-së jashtë Kosovës, zbarkimit të kontingjentit të saj në poligonin ushtarak në Krivollak të Maqedonisë, pastaj rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, ndërtimit të kapaciteteve të SAR-it dhe EOD-it.
Komandanti i FSK-së e njoftoi presidenten për realizimin e shumë projekteve në Kosovë, pastaj, për vizitat zyrtare në Uashington, Ajovë, Shqipëri etj.
Gjeneral Kastrati, në fund e informoi presidenten Jahjaga, për konferencën, "Karta e Adriatikut" e cila do të mbahet në muajin tetor në Tiranë, po ashtu e njoftoi lidhur me përgatitjet për Ditën e FSK-së dhe për pjesëmarrjen e FSK-së në shënimin jubilar të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.
Presidentja Jahjaga ka vlerësuar lart arritjet e Forcës së Sigurisë së Kosovës në të gjitha drejtimet dhe, njëherësh, ritheksoi mbështetjen e saj në përmbushjen e objektivave të përgjithshme të FSK-së.
Ky ishte një takim i rregullt, në të cilin komandanti i FSK-së i raporton presidentes së Republikës së Kosovës, e cila njëherësh është edhe komandante supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së, pritën zëvendësasistenten e sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ministri i FSK-së Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kanë pritë zëvendës asistenten e sekretarit të Mbrojtjes të SHBA-ve për Rusi, Ukrainë dhe Euro-Azi, dr. Evelyn Farkas..
Ministri i FSK-së Agim Çeku e ka njoftuar asistenten Farkas për zhvillimet e deritashme të FSK-së, sfidat dhe vizionin për zhvillimin e ardhshëm.
Një theks i veçantë iu vu bashkëpunimit dypalësh të MFSK-së me vendet fqinje dhe të rajonit, si dhe angazhimet në nismat rajonale të sigurisë.
Nga zëvendës asistentja e sekretarit të Mbrojtjes të SHBA-ve Dr. Evelyn Farkas, u rikonfirmua mbështetja e SHBA-ve në përkrahje të zhvillimit dhe ngritjes së FSK-së. Po ashtu u vlerësua lartë bashkëpunimi i FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës, i cili do të thellohet edhe më tej, si rrugë e bashkëpunimit të ngushtë mes Kosovës dhe SHBA-ve.





Ministri Çeku mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare në qendrën "Marshall"

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës Agim Çeku, që nga data 17-19 shtator, ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare të alumni-ve të shquar, organizuar nga Qendra George C. Mareshal, në Garmisch të Gjermanisë, me temën:"E ardhmja e marrëdhënieve SHBA - Evropë".

Në këtë konferencë kanë marrë pjesë: ministra, ambasadorë dhe personalitete ushtarake nga shumë shtete të botës, ku është diskutuar mbi mundësitë për t'u njohur më mirë lidhur me marrëdhëniet në mes të SHBA-ve dhe Evropës.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti komandantin e Forcave Tokësore të Turqisë



Për nderë të komandantit të Forcave Tokësore të Turqisë, gjeneralit Hayri Kivrikoglu, është rreshtuar Garda ceremoniale e FSK-së, ndërsa Banda frymore e FSK-së ka intonuar himnin kombëtar të Turqisë dhe atë të Kosovës.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me këtë rast e ka falënderuar komandantin e Forcave Tokësore Turke dhe ambasadoren e Turqisë në Kosovë, për ndihmën e vazhdueshme që Turqia dhe Ministria e Mbrojtjes së Turqisë po ua japin Kosovës dhe FSK-së.

Më pas, gjeneral Kastrati e ka njoftuar delegacionin e lartë ushtarak të Turqisë me të arritur at e FSK-së si: plotësimin e kapaciteteve operacionale dhe me objektivat e FSK-së për vitin 2013.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, theks të veçantë i kushtoi bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes së tjera të botës.

Komandanti i Forcave Tokësore të Turqisë, gjenerali Hayri Kivrikoglu, ka falënderuar gjeneral Kastratin për pritjen dhe i ka premtuar ndihmën e Ushtrisë së Turqisë në zhvillimin e mëtejmë të FSK-së. Të dy delegacionet, në përbërje të zgjeruar, kanë vazhduar takimet në Sallën e takimeve, ku përmes një paraqitje të shkurtër, gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione të FSK-së i ka njoftuar më gjerësisht me të arriturat e FSK-së.

Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe zëvendëskomandanti i

Komadanti i FSK-së vizitoi Republikën e Shqipërisë



Me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, për një vizitë zyrtare dyditore, në Shqipëri, ka qëndruar komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Kadri Kastrat i shoqëruar nga gjeneral brigade Nazmi Brahimaj. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati është prit me nderime të larta shtetërore nga Garda e nderit e FA-së të Shqipërisë.

Po ashtu komandanti i FSK-së është prit në një takim të veçantë edhe nga ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë zoti Arben Imami. Me këtë rast, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati e ka falënderuar ministrin e Mbrojtjes z. Imamin, për mbështetjen që Ministria e Mbrojtjes dhe konkretisht Forcat e Armatosura të Shqipërisë i kanë dhënë dhe po i japin në vazhdimësi Forcave të Sigurisë së Kosovës, me qëllim të profesionalizimit, shkollimit dhe trajnimeve. Gjeneral Kastrati shprehi falënderim të veçantë për ministrin e Mbrojtjes së Shqipërisë, për angazhimet e tij që FSK të jetë pjesëmarrëse në nismat dhe aktivitetet regjionale të sigurisë, si dhe për integrimin e FSK-së në strukturat euroatlantike.

Në takimin e përbashkët që zhvilluan gjeneral Kastrati dhe gjeneralmajor Gjunkshi biseduan për bashkërendimin dhe avancimin e bashkëpunimit; në shkollimin dhe trajnimet dypalëshe në mes të FSK-së dhe të FA-së së Shqipërisë. Gjatë takimit u bisedua edhe për përgatitjet që po bën Ushtria Shqiptare për festimin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe për pjesëmarrjen e FSK-së në këtë manifestim.

Komandanti i FSK-së, gjatë qëndrimit në Shqipëri i ka bërë një vizitë Batalionit të Forcave Speciale, ku nga komandanti i tij u njoftua gjerësisht për punën dhe aktivitetin e këtij batalioni.



Turqisë në të gjitha fushat, sipas Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të dy ministrive.

Gjeneral Kastrati e njoftoi delegacionin e Turqisë me trajnimet, ushtrimet si dhe me operacionet që FSK-ja ka kryer dhe po kryen me sukses në vend dhe rajon, pastaj me shkollimin e pjesëtarëve dhe kadetëve të FSK-së në Turqi, SHBA, Shqipëri, Britani të Madhe dhe vende të FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët: Bashkim Jashari, Zymer Halimi dhe Imri Ilazi, Haxhi Shala, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane dhe kolonel Ilir Qeriqi, ndërsa nga delegacioni i Forcave Tokësore të Turqisë ishin të pranishëm ambasadorja e Turqisë në Prishtinë, zonja Songul Ozal, gjeneral brigade Mustafa Yashar, kolonel Aygun Eker etj.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Memorandum Mirëkuptimi mes Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Letonisë dhe Ministrisë së FSK-së

Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës u bë nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet dy ministrive, asaj të Mbrojtjes së Republikës së Letonisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, nga sekretarët e përgjithshëm: Janis Stars dhe Shkëlzen Syla.



Sekretari i përgjithshëm i Mbrojtjes i Republikës së Letonisë Janis Sarts, fillimisht u prit nga ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, të cilët pasi e falënderuan sekretarin e përgjithshëm për ndihmën që Republika e Letonisë i ka dhënë Kosovës dhe FSK-së, e njoftuan atë për të arriturat e FSK-së, plotësimin e kapaciteteve operacionale, bashkëpunimin në rajon dhe botë, si dhe për objektivat e zhvillimit të FSK-së në të ardhmen.

Më pastaj, sekretari i përgjithshëm i Mbrojtjes së Letonisë, Janis Stars pati takime pune me sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së FSK-së, z. Shkëlzen Syla dhe me stafin e lartë të MFSK-së dhe FSK-së. Me këtë rast, kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim në MFSK, përmes një paraqitje të shkurtër, e njoftoi sekretarin e përgjithshëm të Letonisë për misionin, strukturën, shkollimin, trajnimet dhe objektivat e FSK-së.

Pastaj nga ana e sekretarëve të përgjithshëm të dy ministrive z. Stars dhe z. Syla u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi.

Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Syla, pasi ka falënderuar sekretarin e Letonisë për ndihmën që po i jep Kosovës dhe FSK-së, tha: "Nënshkrimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit ka rëndësi të veçantë për FSK-në. Ministria e Mbrojtjes e Letonisë do të përkrahë mbështetjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së. Në takimet e ardhshme të departamenteve përkatëse, do t'i caktojmë edhe prioritet dhe fushat e bashkëpunimit në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë".

Ndërsa, sekretari i përgjithshëm i Letonisë, Janis Stars ka premtuar vazhdimin e ndihmave për FSK-në edhe në të ardhmen; "Ne do t'i përcjellim përvojat tona për zhvillimin e FSK-së, pasi që shumë më herët e kemi kaluar këtë periudhë transitore, me qëllim që mos të përsëriten gabimet e njëjta që ne i kemi bërë".

Letonia është njëri prej shteteve të para që e ka njohur Pavarësinë e Kosovës (20. 02. 2008) dhe që nga viti 2000-2009, ka marrë pjesë me një kontingjent të ushtrisë së saj, në kuadër të KFOR-it, në Kosovë

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr qëndroi për një vizitë pune në FSK



Zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i Komandës së Forcave Tokësore gjeneralmajor Rrahma Rama, ka pritur në ambientet e Kazermës "Adem Jashari" në Prishtinë, komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajorin Timothy Orr me bashkëpunëtorë.

Fillimisht, gjeneral Rama e ka falënderuar komandantin e Gardës Kombëtare gjeneralin Orr për ndihmën e përgjithshme dhe profesionale që Garda Kombëtare e Ajovës po jep për FSK-në. Më pas e ka njoftuar gjeneralin Orr për të arriturat e KFT-së, për trajnimet, dislokimin e FSK-së në Maqedoni, ku morën pjesë edhe pjesëtarë e Gardës Kombëtare të Ajovës, shkollimin e kadetëve, intervenimet e Njësisë së Çminimit në fushat e minuara, atij të MKABK-së, pastaj realizimin e shumë projekteve humanitare dhe për bashkëpunimin në rajon dhe më gjerë.

Në takim morën pjesë edhe zv. komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri.

Të dy delegacionet së bashku kanë vizituar Qendrën Operative të Forcave Tokësore, ku përmes një paraqitje të shkurtër (brifingu), komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, u njoftua për aktivitetet e FSK-së, e sidomos për zhvillimin e konceptit të nënoficerëve, që një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë drejtim po japin oficerët e Gardës Kombëtare të Ajovës .

Më pas ky delegacion i përbashkët zhvilloi vizita edhe në disa nga kazermat e FSK-së. Ata së pari vizituan Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, ku komandanti i saj, major Xhemajli i njoftoi me sistemin e edukimit/shkollimit, metodologjinë e punës dhe sfidat për të ardhmen.

Të dy gjeneralët, Orr dhe Rama, gjatë rrugës për në Gjilan, janë ndalë në Hajvali, ku kanë përcjetën shumë qytetarët të Kosovës. Me këtë rast Gjenerali Orr, premtoi mbështetjen e tij dhe të shtetit të Ajovës për FSK-në.

Delegacionet e kanë vazhduar vizitën në Batalionin e Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, në Gjilan dhe në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Në Gjilan, majorët:



jellë nga afër operacionet e Njësitit të specializuar të Çminimit.

Gjenerali Orr, gjatë vizitës ka shprehur interesimin e tij, për çdo detaj: për pajisjet, për mjetet e pashpërthyera, fushat e minuara, llojet e minave e tjera.

Komandanti i Gardës Kombëtare gjenerali Orr, është ndarë shumë i kënaqur me punën e Njësitit të Çminimit, të cilët kanë eliminuar me mijëra mjete të pashpërthyera dhe kanë pastruar mijëra metra katror të fushave të minuara, ku si pasojë e tyre kanë humbur



Spahiu dhe Shala e kanë njoftuar gjeneralin Orr, me strukturën, detyrat dhe aktivitetet e këtij batalioni. Pjesëtarët e Batalionit të Dytë kanë demonstruar shkathtësitë e tyre, duke improvizuar një pikë kontrolli, që çdo ushtri e zhvillon. Në Ferizaj, gjenerali Orr, është pritë nga komandanti i saj, gjeneral brigade Enver Cikaqi me bashkëpunëtorët, i cili e njoftoi gjeneralin Orr me arritjet dhe aktivitetin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes e në veçanti me trajnimet e njësive të këmbësorisë nga instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr dhe bashkëpunëtorët e tij, janë ndarë të kënaqur për arritjet e FSK-së, në aspektin profesional. Ai në fund premtoi se edhe në të ardhmen do të vazhdoi bashkëpunimi dhe ndihma e pakursyer për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në Kazermën "Adem Jashari" dhanë betimin kadetët e rinj të FSK-së

Në Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcës Tokësore, në Prishtinë, solemnisht dhanë betimin kadetët e Gjeneratës 2016.







Në ceremoninë e betimit morën pjesë: ministri i MFSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjeneral-lejtënant Kadri Kastrati, zv. ministri Bejtush Gashi, zv. komandanti i FSK-së dhe komandant i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët: Bashkim Jashari, Nazmi Brahimaj, Gëzim Hazrolli dhe Enver Cikaqi, drejtori i Universitetit Amerikan në Prishtinë, z. Kris Holl, si dhe oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it dhe familjarë të kadetëve.

Ceremonia filloi me intonimin e himnit kombëtar dhe parakalimin e kadetëve .

Kadetët e rinj të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së i përshëndetën, ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjeneral-lejtënant Kadri Kastrati.

Ministri Agim Çeku në fjalën e tij tha:"Sot është një ditë e veçantë për ju kadetët që po e jepni betimin para prindërve, para ministrit dhe para komandantëve tuaj. Ju që nga sot po e filloni një jetë më ndryshe nga ajo që e keni jetuar deri më tani. Ne jemi sot të gjithë këtu, për ju, ju duhet të jeni krenar që patët fatin që nga 3500 konkurruesit e tjerë, u përzgjodhët të jeni pjesë e këtij rreshti. Ju sot po merrni obligime të mëdha. Që nga sot ju po e filloni shkollimin tuaj për të qenë të vlefshëm, kuptohet për vetën tuaj, por në radhë të parë të vlefshëm për vendin dhe për qytetarët e vendit tonë. Ju sot po merrni përgjegjësi të reja, po betoheni para flamurit, para prindërve, para komandantëve tuaj, që do të jeni të përkushtuar ndaj vendit, ndaj atdheut, duke pasur gjithmonë parasysh moton e ushtarakut: nderi, detyra dhe atdheu mbi të gjitha".

Ministri i FSK-së Agim Çeku ua ka rikujtuar kadetëve të rinj se "Që nga sot, ju përveç se jeni qytetarë, jeni në radhë të parë ushtarë" dhe në çdo situatë, në çdo rrethanë duhet ta dini se kush jeni dhe si duhet të veproni, prandaj jeni ndryshe nga moshatarët tuaj, ju keni përzgjedh një profesion të vështirë i cili kërkon vetëmohim, përkushtim dhe guxim, por mbi të gjitha është një profesion shumë fisnik, ku nuk ka gjë më të mirë se sa shërbimi për vendin dhe popullin tënd. Ju e kishit këtë fat. Andaj mos harroni se në asnjë moment nuk duhet të dështoni, përkundrazi duhet të jeni shembull çdo kund; në kazermë, në universitet, në rrugë. Keni detyrë nga unë dhe nga komandanti që të jeni më të mirët. Do të kaloni edhe ditë të vështira, por të gjitha vështirësitë janë për të mirën tuaj, me qëllim që të përgatiteni sa më mirë për të qenë ushtarë dhe oficerë të denjë. Duhet të punoni si ekip dhe ta doni njeri- tjetrin, mos lejoni që ekipi të ndëshkohet për shkakun e njërit".

Në fund ministri Çeku ka falënderuar edhe familjarët e kadetëve: "Të nderuar prindër, e di që edhe ju jeni krenar për djemtë dhe vajzat tuaja, ju falënderoj që mbështetet kadetët tanë në synimin dhe dëshirën e tyre për tu bërë ushtarë të vendit, ku prej tyre nesër presim edhe gjeneral të ardhshëm".

Fjala e komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastratit

"Të nderuar të pranishëm!

Dita e sotme është e një rëndësie të veçantë për Qendrën për Studime Universitare, për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe për mua personalisht.

Ne jemi të përkushtuar që ta ndërtojmë një forcë moderne e profesionale të sigurisë të trajnuar dhe të pajisur me infrastrukturë sipas standardeve të NATO-s.

Për arritjen e këtij objektivi (standardi) nuk mjafton vetëm dëshira dhe përkushtimi i pjesëtarëve të FSK-së, por duhet edhe arsimimi profesional dhe dija e avancuar në këtë fushë.

FSK-ja këtë objektiv po e përmbush përmes Qendrës për Studime Universitare e në bashkëpunim edhe me Universitetin Amerikan në Kosovë dhe me universitet e tjera brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.

Edhe gjatë këtij viti interesimi i të rinjve për ta veshë uniformën e kadetit të Qendrës për Studime Universitare të FKS-së, ka qenë shumë i madh. Para jush, janë rreshtuar kadetët më të mirë, që me sukses i kanë kaluar të gjitha testimet si dhe kanë përballuar me sukses javën e fundit, të ashtuquajtur java e ferrit. Për kalimin me sukses të kësaj sfide ju përgëzoj.

Unë edhe njëherë kërkoi nga i gjithë stafi i Forcës së Sigurisë të Kosovës, nga Qendra për Studime Universitare dhe nga kadetët e posa pranuar angazhim maksimal, disiplinë të vazhdueshme dhe këmbëngulëse, duke ju përkujtuar se jeni përzgjedhur në një konkurrencë shumë të madhe.

Për këtë, jeni të privilegjuar nga moshatarët tuaj, sepse Ju nga lëmi i artit ushtarak do të arsimoheni dhe edukoheni në kuadër të FSK-së dhe si oficerë të ardhshëm, këtë arsimim do ta veni në shërbim të sigurisë së vendit.

Te nderuar kadet!

Ju duhet t'i përkushtoheni me vullnet profesionit të ushtarakut që vet e keni zgjedhur dhe ju gjithmonë duhet të keni parasysh tri elementet kryesore të një ushtaraku e që janë: Detyra, Nderi dhe Atdheu! 412 kadetët e rinj solemnisht dhanë betimin para ministrit Agim Çekut, gjeneralit Kadri Kastratit, stafit komandues të FSK-së, të QSU-së dhe familjarëve të tyre.

Pas përfundimit të ceremonisë, familjarët së bashku me kadetët, vizituan ambientet e QSU-së, ku u njoftuan me kushtet e kësaj qendre, në të cilën kadetët do të mësojnë dhe do të qëndrojnë gjatë katër vjetëve të studimeve.



Certifikohen nënoficerët e lartë të FSK-së

Me një ceremoni të organizuar në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në Ferizaj, u bë certifikimi i tridhjetë e shtatë nënoficerëve të lartë. Në ceremoni morën pjesë; zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Enver Cikaqi, rreshter e Gardës Kombëtare të Ajovës, Rachel Fails, si dhe oficerë të lartët të FSK-së dhe të KFOR-it.

Me këtë rast, zv. komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli përshëndeti të gjithë nënoficerët dhe instruktorët për angazhimin maksimal në kryerjen e detyrave të parashtruara nga eprorët e tyre. Njëherësh nga ta, kërkoi ngritjen e efikasitetit të punës në njësitet e tyre, ku janë duke shërbyer, si dhe përcjelljen e njohurive të fituara nga ky trajnim i rëndësisë së veçantë. Ai ndër të tjera tha: "Nga ky trajnim ju keni fituar të gjitha njohuritë dhe keni marrë përgatitjet e duhura që të udhëhiqni me shembullin tuaj personal njësitë dhe trupat.

Ndërsa, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, nënoficerëve të certifikuar iu ofroi mbështetje të pakursyer për zbatimin në praktikë të përvojave të fituara, njëherësh i përgëzoi për ecurinë dhe angazhimin maksimal që kanë treguar gjatë këtij trajnimi. Po ashtu falënderoi ekipin amerikan veçanërisht, rreshterin Fails të cilës më këtë rast iu nda mirënjohje për bashkëpunim të shkëlqyer në këtë trajnim.

Rreshter major Fails pasi përshëndeti të pranishmit theksoi rëndësinë e trajnimit, i cili ishte i ndërthurur me aktivitete fizike dhe mentale dhe për disa përveç trajnimit bazik ky ishte trajnim i parë për udhëheqje i këtij lloji. " Unë nga afër e kam përcjell performancën tuaj, shkathtësitë tuaja në marrjen e vendimeve dhe jam e kënaqur me arritjet tuaja, edhe pse të jesh lider nuk është gjithnjë e lehtë"

Në fund të ceremonisë u ndanë certifikatat për nënoficerët. Ndërsa për tre nënoficerët e dalluar kapter Fahri Palojën, rreshter major Gani Dilaverin dhe kapter Selami Ibishin u ndanë mirënjohje për përkushtimin e treguar gjatë punës së vazhdueshme dhe të vëmendshme deri në detaje, si dhe për ndihmën e tyre dhënë kolegëve gjatë këtij kursi.

Gjithashtu, në KDS, janë certifikuar edhe 66 pjesëtarë të cilët kanë kryer trajnime në fusha të caktuara specialistike si: inxhinieri, kërkim-shpëtim, logjistikë, komunikim dhe ndihmë mjekësore.

Në certifikimin e tyre kanë marrë pjesë komandanti i KDS-së gjeneral Cikaqi dhe oficerët e lartë të FSK-së dhe të KFOR-it.



U mbajt konferenca me titull “Forca e Sigurisë së Kosovës në komunitete”

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës u mbajt konferenca e dytë brenda këtij viti për komunitetet në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Konferenca është organizuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në MFSK në bashkëpunim dhe me përkrahje të ministrit të FSK-së Agim Çeku, komandantit të FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati, Departamentit të BCU-së si dhe ekipit këshillëdhënës të NATO-së.
Konferencën me temë "Forca e Sigurisë së Kosovës në komunitete" e hapi ministri i FSK-së Agim Çeku i cili në fjalën e tij tha: " FSK-ja është duke u angazhuar për të ndihmuar të gjitha komunitetet. Për këto projekte të realizuara nga FSK-ja në bashkëpunim me Departamentin për Bashkëpunim Civil-Ushtarak, jam krenar me punën dhe me profesionalizmin e treguar. Sfidë e rëndësishme është fitimi i besimit të pjesëtarëve të komuniteteve, prandaj ne duhet të analizojmë çfarë kemi bërë mirë deri më tash dhe çka duhet të bëjmë në të ardhmen.
Realizimi i këtyre projekteve të bashkëpunimit me komunitet nuk është i rëndësishëm vetëm për FSK-në, por edhe për Qeverinë e Kosovës. Unë kërkoj nga përfaqësuesit ndërkombëtarë që ndihmën e tyre për komunitete ta bëjnë duke ndihmuar FSK-në që të zhvillojë projekte bashkëpunimi me komunitetet".

Prezantimin për komunitete në FSK e bëri Azemina Çulum, shefe e Zyrës për Komunitete dhe Barazi Gjinore në MFSK. Fushat që kërkojnë vëmendje sipas këtij prezantimi janë; infrastruktura, shëndetësia, edukimi dhe ndërtimi i kapaciteteve, ku përmes asistencës humanitare do të kontribuohet në zhvillimin ekonomik dhe social të njerëzve, për të ndërtuar jetën cilësore, me çka do të promovohen marrëdhëniet e mira në mes komuniteteve në MFSK
Gjatë periudhës dyvjeçare FSK-ja ka përfunduar shumë projekte humanitare, në shumë vende të Kosovës të banuara me komunitete të ndryshme, ndër to janë fshatrat Dragolevac dhe Zallq, ku FSK-ja ka ofruar përkrahje në projekte të ndryshme humanitare të infrastrukturës dhe asistencës mjekësore. Po ashtu FSK-ja ka bërë edhe zgjerimin e shtratit të lumit Janjeva në Lipjan si dhe ka ndihmuar në pastrimin e oborrit dhe të varrezave nga minat, në kishën e Shën Nikollës në Prishtinë.
Programi arsimor për komunitetet ishte po ashtu një objektiv i rëndësishëm që FSK-ja e ka përmbushur më sukses në ligjëratat për rrezikun nga minat, të mbajtura në 15 shkolla të Kosovës.
Pjesëtarët e FSK-së, në kushte të rënda të dimrit që shkoi, në situata emergjente kanë punuar me shumë sukses në pastrimin e borës, në dërgimin e ushqimit dhe medikamenteve në këto komuna si: Komunën e Prishtinës, Podujevës, Kaçanikut, Lipjanit, Dragashit, Novo Bërdës, Vushtrrisë, Mitrovicës, Shtërpcës, Ranilugut, Kastriotit, Graçanicës dhe Fushë Kosovës.
Me diskutimet e tyre kontribuuan: ministri për Kthim Radojica Tomiç, ambasadori i Norvegjisë, përfaqësuesi i ambasadës së Holandës, Radmila Smiloviq shefja e Zyrës së Komuniteteve nga Komuna e Lipjanit dhe të tjerë.
Pjesëmarrës në konferencën "Forca e Sigurisë së Kosovës në komunitete" ishin: ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministri i FSK-së Bejtush Gashi, zëvendësministri Sllavisha Filipoviq, ministri për Kthim i në Qeverinë e Kosovës Radojica Tomiç, përfaqësues të Zyrës për Komunitete nga Zyra e Kryeministrit, ambasadorë, atashe ushtarak, zyrtarë të lartë në MFSK, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të komunave, përfaqësues të komuniteteve dhe OJQ-ve.



Përfundoi me sukses kursi për taktika të njësive të vogla të këmbësorisë



Në kazermën e FSK-së në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në Ferizaj prej datës 27 gusht deri më 14 shtator u mbajt ceremonia e përfundimit të kursit të këmbësorisë për udhëheqës të njësive të vogla prej 52 pjesëtarësh të FSK-së..
Pjesëtarët e Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, janë trajnuar nga instruktorët amerikan të cilët vinë prej Organizatës së Asistencës së Sigurisë së Menaxhimit të Trajnimeve të Ushtrisë Amerikane nga Fort Bragg, Karolina e Veriut, si dhe nga Qendra Luftarake e Gardës Nacionale të Ushtrisë nga Fort Bennin, Georgia, në bashkëpunim me instruktorët e FSK-së.
Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati tha: "Ky trajnim shënon një sukses të radhës për FSK-në dhe është tregues se zhvillimi i Brigadës së Reagimit të Shpejt (BRSH) është një nga prioritetet e FSK-së. Pjesëtarët që kanë pasur mundësi ta ndjekin këtë kurs tre javorë kanë marr shkathtësi të cilat rrisin më tutje kapacitetet e FSK-së dhe ky trajnim do të ndikojë edhe në ngritjen e karrierës së këtyre pjesëtarëve. Pres që këto shkathtësi t'i bartni tek pjesëtarët tjerë nëpër njësitë tuaja dhe pres nga BRSH-ja që të organizojë trajnime rifreskuese në mënyrë që të ruhen këto shkathtësi dhe të përcillen gjeneratë pas gjenerate, përherë, në FSK".
Kapiten Kris Gullixson, udhëheqës i ekipit trajnues amerikan tha se 52 oficerët dhe nënoficerët që kanë përfunduar këtë kurs rigoroz tre javorë janë testuar si fizikisht ashtu edhe mendërisht në shumë detyra dhe aftësi. Ata gjithashtu kanë marrë mësim edhe për procedurat e udhëheqjes së trupave, dhënien e urdhrave, operacionet e njësiteve të vogla dhe manovrimet gjatë betejës.
Të gjitha këto aktivitete pjesëtarët kanë pasur mundësi t'i realizojnë gjatë tri javëve në kazermën e KDS-së. Aktivitetet kanë filluar nga ora 5 e mëngjesit dhe kanë vazhduar deri në orën 21 të mbrëmjes.
Kris Gullixson shtoi se pjesëtarët e FSK-së është dashur të zgjedhin komandën në skuadrën e tyre dhe vazhdimisht kanë qenë nën mbikëqyrje dhe vlerësim të vazhdueshëm, se sa mirë e kanë kapur konceptin e ushtrimit duke e paraqitur një plan në detaje, duke zhvilluar bashkërendime, duke bërë përsëritjet e planit dhe duke ekzekutuar një patrullë në lëvizje për ta përfunduar misionin e dhënë.
Në aktivitetet që kanë bërë pjesëtarët gjatë këtyre tri javëve janë përfshirë pompat, barkoret, 5 mile vrap me kohë të caktuar, 2 mile vrap me shokun duke përfshirë të gjitha pajisjet dhe armën dhe 8 mile marshim me të gjitha pajisjet si dhe në fund ka qenë testimi i mbijetesës në ujë.
Në këtë ceremoni u certifikuan 52 pjesëtarë të cilët përfunduan me sukses kursin për taktika të njësive të vogla të këmbësorisë dhe dy pjesëtarë, nëntoger Gëzim Osmani dhe rreshter Xhevdet Zymberi u shpërblyen si pjesëtarët më të dalluar gjatë këtij kursi. Po ashtu nga nënkolonel Ray Wojcik, shef i Zyrës së Bashkëpunimit Ushtarak i Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, mirënjohje e veçantë ju nda gjeneralit të brigadës Enver Cikaqit, një mirënjohje KDS-së si dhe instruktorëve të FSK-së.
Ky trajnim është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në mes të FSK-së dhe SHBA-ve, gjë qe tregon mbështetjen e SHBA-ve për FSK-në dhe për Kosovën në përgjithësi.
Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishin komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, atasheu ushtarak amerikan, Klonel James Skot, gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Bashkim Jashari si dhe oficerë të tjerë të lartë të FSK-së dhe të KFOR-it.



Fotoreportazh nga aktivitetet e njësive të specializuara të FSK-së













Seminar i përbashkët i FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës

Në Komandën e Forcave Tokësore, përkatësisht në ambientet e Brigadës së Mbështetjes Operacionale të FSK-së, për tri ditë rresht u mbajt seminari i përbashkët ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Ajovës dhe FSK-së



Seminari i filloi punimet më 18 shtator dhe morën pjesë përfaqësuesit më të lartë të MFSK-së dhe të Gardës Kombëtare të Ajovës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Seminarin e shpalli të hapur kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në FSK. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në fjalën e tij pasi përshëndeti oficerët e Gardës Kombëtare të Ajovës dhe zyrtarët e Ministrisë dhe oficerët e FSK-së, u ndal më shumë te objektivat, qëllimi dhe synimet e FSK-së për vitin 2013.

Qëllimi primar i mbajtjes së seminarit të përbashkët është shkëmbimi i përvojave në mes Gardës Kombëtare të Ajovës dhe FSK-së, përmes planifikimit teorik dhe praktik-mësimorë në grupe punuese, midis oficerëve të Ajovës dhe FSK-së, për vitin 2013 dhe që adreson ushtrimet dhe ngjarjet për vitin 2014.

Më 18 shtator, filluan seancat plenare me qëllim të standardizimit dhe të bashkërendimit të dokumenteve të përafërta. Përpilimin e udhëzuesve për vitin 2013-të dhe shqyrtimin e projekt-kalendarit të veprimeve të përbashkëta, që ato të përputhen me qëllimet dhe me objektivat e MFSK-së / Komandës së FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës.

Më 19 shtator, vazhduan aktivitet e parapara në grupe punuese të sektorëve të caktuar për analiza dhe përgatitja e raportit përmbledhës, përmes shtjellimit të objektivave të përbashkëta për vitin 2013-2014.

Kolonelët Altman dhe Freese nga Garda Kombëtare e Ajovës, në fund u shprehën se janë



Më 20 shtator u raportua për punën e grupeve punuese të FSK-së dhe të Gardës Kombëtare të Ajovës.

Në përmbylljen e punimeve të seminarit morën pjesë komandanti dhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrai dhe gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët: Imri Ilazi dhe Gëzim Hazrolli, sekretari i përgjigjëm i MFSK-së, Shkëlzen Syla, oficerë dhe zyrtarë të tjerë të lartë të FSK-së, të cilët me angazhimet e tyre ndihmuan maksimalisht që seminari t'i kryej punimet me sukses.



shumë të kënaqur, pasi që ia kanë arrit qëllimit të përbashkët, që seminari të jetë i suksesshëm, dhe premtuan për vazhdimin e bashkëpunimit në nivelin më të lartë, në mes Gardës së Ajovës dhe FSK-së në të ardhmen.

Në fund komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati ka falënderuar Gardën Kombëtare të Ajovës dhe në veçanti komandantin e saj, gjeneralin Orr, për angazhimin e gjithanshëm dhe për bashkëpunim në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Qëllimi i përbashkët u arrit për përgatitjen dhe botimin e një kalendari stërvitor, për vitin 2013/2014 midis Ajovës dhe FSK-së.

Zëvendësministri Shemsi Veseli priti atasheun ushtarak të Japonisë

Shemsi Veseli zëvendësministër i Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim, kanë prit sot, në një takim atasheun ushtarak të Japonisë, në Austri, kolonelin Tsutomu Sone, i cili është përgjegjës edhe për Kosovë.

Vizita e atasheut të ri ushtarak të Japonisë, kishte për qëllim njohjen me stafin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Me këtë rast, zëvendësministri Shemsi Veseli e ka falënderuar kolonelin Sone, për tërë atë që Japonia ka bërë dhe po bënë për Kosovën dhe FSK-në.

Po ashtu e ka njoftuar atasheun ushtarak me të arriturat; shkollimin, trajnimet, bashkëpunim e përgjithshëm dhe me objektivat për zhvillimin e FSK-së në të



ardhmen.

Në këtë takim u arrit marrëveshja, që së shpejti të përgatitet draft- dokumenti për bashkëpunim ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Japonisë.

Koloneli Tsutomu Sone ka falënderuar zëvendësministrin Shemsi Veselin për pritjen dhe ka premtuar ndihmë për FSK-në.

Debat publik për draftin fillestar të Projektligjit për dërgimin e pjesëtarëve/ kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Me këtë ligj rregullohet çështja e dërgimit të pjesëtarëve/kontingjentit të FSK-së jashtë vendit. Ky ligj përcakton kompetencat dhe përgjegjësit e institucioneve në rastet e dërgimit të pjesëtarëve të FSK-së jashtë vendit si dhe procedurat për dërgim në operacione paqeruajtëse, operacione humanitare/ emergjente dhe aktivitete tjera, mënyrën e tërheqjes, zëvendësimit dhe mënyrën e financimit.

Pjesëmarrës në këtë debat ishin zëvendës ministrat; Shemsi Veseli, Bejtush Gashi, Sllavisha Filipviq, sekretari i përgjithshëm, Shkelzen Syla, drejtorë të drejtorive në MFSK, gjeneral Zymer Halimi, kolonel Naim Haziri shefi i shtabit të KFT-së, ekspertë të pavarur të fushës së sigurisë, përfaqësues të jetës akademike, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve si dhe oficerë të FSK-së.

FORCA JONË

* * * Viti I • Nr. 6 • Nëntor 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministria e FSK-së dhe Ministria e Mbrojtjes së Gjermanisë nënshkruan Memorandumin për Bashkëpunim



Ministri i FSK-së, Agim Çeku së bashku me një delegacion, më 25 dhe 26 tetor, kanë qëndruar për një vizitë zyrtare, në Gjermani. Gjatë vizitës, ministri i FSK-së Agim Çeku është pritur nga Ministri i Mbrojtjes së Gjermanisë, Dr. Thomas de Maiziere, Sekretari Parlamentar i Shtetit Mr. Chrisatian Schmidt, Komisioni Parlamentar për Mbrojtje të Gjermanisë dhe Ministri i Brendshëm i Bavarisë.

Në Ministrinë e Mbrojtjes të Gjermanisë është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë. Për Ministrinë e Mbrojtjes të Gjermanisë, memorandumin e nënshkroi Sekretari Parlamentar i Shtetit, Mr. Christian Schmidt dhe për MFSK-në, ministri Agim Çeku. Memorandumi parasheh thellimin e bashkëpunimit në shumë fusha përkatëse e që janë me interes të dyanshëm për të dyja shtetet.

Ministri Agim Çeku gjatë qëndrimit në Gjermani është pritur edhe nga përfaqësues të Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, ku ministri Çeku, me këtë rast i ka njoftuar përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes për të arriturat e FSK-së, plotësimin e kapaciteteve operacionale, si dhe bashkëpunimin në Rajon dhe më gjerë.

Gjithashtu është konkretizuar realizimi i bashkëpunimit për mësimin e gjuhës gjermane, përzgjedhjen dhe përgatitjen e instruktorit të gjuhës gjermane, i cili që nga shtatori i këtij viti do t'i trajnojë pjesëtarët e FSK-së, të paraparë për trajnim dhe shkollim, në Gjermani. Për këtë do të përgatitet edhe kabineti i gjuhës gjermane në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj.

Gjatë qëndrimit në Gjermani është biseduar edhe për akreditimin e atasheut të FSK-së në Berlin, si dhe janë trajtuar edhe shumë çështje tjera që thellojnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin me interes të përbashkët në mes dy ministrive përkatëse dhe dy shteteve mike.

Delegacioni i FSK-së është pritur edhe në Ministrinë e Brendshme të Bavarisë. Në fund të vizitës, nën organizimin e CSU-së (parti politike), në qytetin e Munihut është mbajtur konferenca për media "Kosova Storie e Suksesit"



Gjeneral Kastrati vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes së Malit të Zi

Me ftesë të Shefit të Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me bashkëpunëtorë, qëndruan për vizitë zyrtare dyditore në Mal të Zi.

Komandanti i FSK-së, në kryeqytetin e Malit të Zi, është pritur nga Njësia Ceremoniale e Ushtrisë së Malit të Zi .

Kjo ishte vizita e parë zyrtare e komandantit të FSK-së në Malit të Zi.

Gjeneral Kastrati dhe shefi i Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi nënadmirali Dragan Samarxhiq, fillimisht patën një takim kokë me kokë dhe më pas takimi ka vazhduar në përbërje të plotë të të dy delegacioneve.

Komandanti i FSK-së, gjatë vizitës, shoqërohej nga gjeneral brigade Imri Ilazi, major Fadil Hoxha dhe Kosum Kosumi. Në takimin e përbashkët u bisedua për fushat e bashkëpunimit, si dhe për gatishmërinë e dyanshme për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy ministrive në fushatë përkatëse, me theks të veçantë, në fushat e trajnimit dhe ushtrimeve të përbashkëta. Për zhvillimin e këtij bashkëpunimi ekziston vullnet i dyanshëm dhe mundësi të mira për të kontribuar në fushën e sigurisë së bashku me ushtritë tjera të rajonit.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, u prit edhe nga zëvendësministri i Mbrojtjes së Mali të Zi, Ivan Mashulloviq me bashkëpunëtorë dhe nga shefi i Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi nënadmirali Dragan Samarxhiq. Në takim u ritheksua nevoja e konkretizimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të dy ministrive në fushat përkatëse, iniciativat regjionale të sigurisë, duke kontribuuar në sigurinë e regjionit dhe më gjerë.

FSK-ja pjesë e paradës në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë



Në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë, për herë të parë, përkrah Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, më 28 Nëntor, do të parakalojë edhe një Kuadrat i FSK-së



Ministri Agim Çeku ka marrë mbështetje nga Letonia

Ministri Agim Çeku dhe zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Rrahman Rama, me bashkëpunëtorë, u pritën në kryeqytetin e Letonisë, në Riga, nga ministri i Mbrojtjes Artis Pabriks.

Ministri i Letonisë i ka konfirmuar ministrit Agim Çekut, gatishmërinë për të vazhduar mbështetjen në zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri i Mbrojtjes së Letonisë i ka ofruar ministrit të FSK-së, Agim Çekut vazhdimin e bashkëpunimit dypalësh, si dhe trajnimin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në, përgatitjen e ekspertëve të lëndëve plasëse, në shkollën e nënoficerëve ushtarak të Forcave të Armatosura Kombëtare, shkollimin për instruktorë, si dhe takimin e ekspertëve të ministrisë, të sistemit të menaxhimit dhe planifikimit.

Ministri i FSK-së Agim Çeku, me këtë rast, ka falënderuar ministrin e Mbrojtjes dhe Qeverinë e Letonisë për mbështetjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës në zhvillimin e saj, që është thelbësorë për Kosovën, si një proces i pavarur drejt shtet-ndërtimit.

Gjatë takimit, ekspertët e të dyja ministrive, përmes një plani paraqiten fushat e mundshme të bashkëpunimit. Po ashtu gjatë takimit u diskutua edhe për situatën e sigurisë në Ballkan, si dhe për perspektivat e zhvillimit dhe integrimit në strukturat euro-atlantike të Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në fund, ministri i Mbrojtjes i Letonisë premtoi ndihmën dhe mbështetjen e tij, për aspiratën e FSK-së dhe të Kosovës, në integrimet evropiane dhe euro-atlantike.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku dhe bashkëpunëtorët vizituan gjithashtu edhe shkollën për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera (EOD), Akademinë Kombëtare të Mbrojtjes, si edhe shkollën e gjuhëve të huaja.

Ministria e Mbrojtjes e Letonisë, vazhdon të ndihmojë FSK-në, përmes procesit të dërgimit të ekspertëve në Grupin Këshillues të NATO-s. Aktualisht, në Ministrinë e FSK-së, punojnë dy këshilltarë, një këshilltar ligjor dhe një në marrëdhëniet me publikun.

Admirali Mark Mongomeri: Ushtria amerikane vazhdon mbështetjen për FSK-në



Admirali amerikan Mark Montgomeri, zëvendësdrejtor i Politikave, Planeve dhe Strategjive në Komandën Amerikane për Evropë (EUCOM) me bashkëpunëtorë, ka qëndruar për një vizitë pune në Ministrinë e FSK-së, ku është pritur nga ministri Agim Çeku, zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneralmajor Rrahman Rama dhe sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Syla.

Ministri Çeku ka falënderuar admiralin Montgomeri dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e vazhdueshme që po i japin FSK-së, dhe njëherësh e ka njoftuar admiralin me zhvillimet e FSK-së, si dhe me rishikimin e Strategjisë së Sektorit të Sigurisë për vitin 2013.

Admirali Mantgomeri gjatë vizitës ka konfirmuar mbështetjen e mëtejme të SHBA-ve për FSK-në.

Admirali Montgomeri, po sot, vizitoi edhe njësitet e FSK-së, në Ferizaj dhe Mitrovicë.

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së, në Ferizaj, delegacioni amerikan u prit nga komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili e ka njoftuar admiralin Mantgomeri me të arriturat dhe planet e zhvillimit të KDS-së dhe të FSK-së.

Gjatë kësaj vizite admirali Montgomeri edhe njëherë ka konfirmuar mbështetjen për FSK-në, si në: trajnime, edukim dhe pajisje. Me këtë rast ai u interesua të dijë më shumë për kërkesat dhe nevojat që ka KDS-ja, me qëllim që t'i ndihmohet FSK-së, për të qenë sa më e suksesshme. Po ashtu, admiral Montgomeri së bashku me gjeneral Cikaqin, bënë vizita në qendrat trajnuese të KDS-së, në Kursin për udhëheqës luftarak, i cili po mbahet nga Ekipet Mobile të SHBA-ve, të cilat trajnime janë shumë të rëndësishme për FSK-në.

Pas vizitës në KDS, admirali Mark Montgomeri së bashku me bashkëpunëtorë ka vizituar edhe Batalionin e Brigadës për Reagim të Shpejtë në Mitrovicë, ku ka përcjellë nga afër trajnimet e këtyre njësive.

Gjeneralbrigade Enver Cikaqi vizitë zyrtare në Ushtrinë e Turqisë



Me ftesë të komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së Turqisë, gjeneralit Servet Yoruk, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi së bashku me një delegacion oficerësh të KDS-së, kanë qëndruar për një vizitë zyrtare, pesëditore, në Turqi.

Delegacioni i FSK-së, është pritur nga komandanti i KDS-së, të Turqisë, gjenerali me katër yje, Servet Yoruk. Të dy gjeneralët gjatë takimit kanë biseduar për të arriturat e dyanshme, si dhe fushat e mundshme të bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Takimet e dyanshme janë vazhdim i bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Ministrisë së FSK-së/FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Ushtrisë së Turqisë.

Gjeneral Enver Cikaqi gjatë qëndrimit në Ankara dhe Stamboll, ka vizituar shumë shkolla ushtarake që veprojnë në kuadër të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Ushtrisë së Turqisë, ku nga komandantët e shkollave turke, është njoftuar me programet shkollore të fushave të ndryshme ushtarake dhe për përgatitjen e kadetëve në këto shkolla.

Delegacioni i FSK-së, gjatë qëndrimit në Turqi, ka vizitua edhe Akademinë Ushtarake të Turqisë, ku është pritur nga komandanti i Akademisë, gjeneral brigade Murat Jetki dhe gjashtë kadetët e FSK-së, të cilët po kryejnë shkollimin në këtë Akademi Ushtarake. (shkollimi zgjatë 4 vjet).

Në Stamboll, gjeneral Cikaqi, ka qëndruar edhe në Departamentin e Planifikimit të Doktrinave dhe Publikimeve, Kabinetin e EOD (Deminim-minim), ku është pritur nga gjeneral major Gyktyrk Gykbajrak i cili e ka njoftuar gjeneral Cikaqin me programet e shkollës, me realizimin e kurseve të ndryshme brenda shkollës, shkollën e gjuhëve të huaja, (ku takoi disa nga kadetët e FSK-së, që ndjekin kursin e gjuhës turke në këtë shkollë).

Të gjithë gjeneralët e ushtrisë së Turqisë, kanë shprehur gatishmërinë e tyre, për ta ndihmuar FSK-në, në të gjitha fushat dhe veprimtaritë tjera, ku ka nevojë Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së. Gjeneral Cikaqi,në emër të KDS-së dhe të FSK-së, ka falënderuar Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së Turqisë, për bashkëpunimin si dhe për ndihmën e ofruar në trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së.

Komandanti i FSK-së mori pjesë në Konferencën e 16-të të Kartës së Adriatikut

Në Tiranë, nga data 9-11 tetor 2012, zhvilloi punimet Konferenca e 16-të e Kartës së Adriatikut në nivelin e shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve anëtare të kësaj iniciative rajonale, ku për herë të parë, mori pjesë edhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në cilësinë e vëzhguesit dhe të ftuarit special.

Në Konferencën e 16-të të Kartës së Adriatikut morën pjesë shefi i Shtabit të Ushtrisë së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, mori pjesë edhe zëvendëskomandanti i Komandës Amerikane për Evropë (USEUCOM) dhe zëvendës- komandanti i JFC-së i Napolit.

Fjalën e hapjes e mbajti shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjenerallejtënant Drago Lovriç, në cilësinë e kryetarit të radhës së A5. Ndërsa, në emër të ministrit të Mbrojtjes Arben Imami, Konferencën e 16-të të Kartës së Adriatikut e përshëndeti zëvendësministri i Mbrojtjes Arian Starova.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Shqipërisë, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, e vlerësoi lartë nivelin shumë të mirë të bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare të A5, si dhe shprehu bindjen se ky bashkëpunim do të forcohet më tej, në të ardhmen, nëpërmjet projekteve të përbashkëta.

Në konferencë është diskutuar për çështjet e përcaktuara në program, si për bashkëpunimin rajonal, për ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme nëpërmjet mbështetjes së stërvitjeve dhe operacioneve të përbashkëta, për vijimësinë e procesit të transformimit të Forcave të Armatosura, për qasjen rajonale ballkanike dhe për mbrojtjen ajrore etj.

Gjithashtu në konferencë u prezantuan rezultatet e arritura të grupeve punuese dhe u diskutua për nevojën dhe sfidat e rritjes së bashkëpunimit regjional mes forcave të armatosura të rajonit. Të gjitha vendet prezantuan kapacitetet, kontributin e tyre rajonal dhe global si dhe shfaqen gatishmërinë e rritjes së bashkëpunimit, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe angazhimit të përbashkët. Po ashtu u shtrua nevoja e shkëmbimit të përvojave në mes shteteve të rajonit, përmes ushtrimeve të përbashkëta, shkëmbimit të përvojave në proceset e transformimit dhe integrimit në NATO dhe nevoja e gjetjes së mundësive, për të ulur kostot përmes konceptit „SMART DEFENSE".

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Kadri Kastrati gjatë kësaj konference takoi homologët e vendeve pjesëmarrëse, pati takime edhe me zëvendëskomandantin e USEUCOM , nënadmiralin Martoglio, të cilin gjeneral Kastrati e njoftoi për arritjet dhe për të ardhmen e FSK-së. Ai e informoi admiralin edhe rreth punës që po bëhet në rishikimin e Sektorit të Sigurisë, ngritjen e Task- Forcës, të Kërkim-Shpëtimit dhe gatishmërinë e FSK-së për të qenë pjesë e nismave dhe angazhimeve rajonale.

Nënadmirali Mortoglio vlerësoj lartë të arriturat e FSK-së dhe u pajtua me nevojën e pjesëmarrjes së FSK-së, në të gjitha nismat rajonale.

Gjithashtu komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati takoi edhe Admiralin Mark Montgomerin zëvendësdrejtor i J5, në USEUCOM dhe zëvendësshefin e Shtabit për Operacione në Komandën e Forcës së Bashkuar të Napolit, gjeneralmajor Garry Dean, si dhe përfaqësues nga NCIA e NATO-s. Qëllimi i konferencës ishte ri-afirmimi i përpjekjeve të përbashkëta të vendeve të A5 për bashkëpunim dhe integrim në strukturat euroatlantike të sigurisë.

Shtetet e shefat e Shtabit te Përgjithshëm të vendeve të A5 dhe të ftuarit e tjerë në këtë takim vlerësuan punimet e kësaj konference si një tregues domethënës i bashkëpunimit të frytshëm të vendeve të A5, si në kuadrin rajonal, ashtu edhe në mbështetje të operacioneve të NATO-s.

Në fund të takimit të 16-të të Kartës së Adriatikut është miratuar dhe nënshkruar edhe një Deklaratë e Përbashkët.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Komisioni Parlamentar për punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së vizitoi kazermën "Ushtarët e NATO-s"

Delegacioni i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së i kryesuar nga Ahmet Isufi dhe i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, vizituan Brigadën e Reagimit të Shpejtë në kazermën "Ushtarët e NATO-s", në Istog, të cilët i priti komandanti i kësaj brigade gjeneral brigade Nazmi Brahimaj.

Me një paraqitje të shkurtër informuese, shefi i shtabit të BRSH-së, nënkolonel Jeton Dreshaj, e njoftoi komisionin për aktivitetet e kësaj brigade, misionin, personelin, trajnimet, pajisjet, forcën reaguese dhe sfidat në përmbushjen e mandatit të saj, si dhe përgatitjet e togut të FSK-së për parakalimin e tyre në 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së shtetit shqiptar.



Kryetari i komisionit Ahmet Isufi u shpreh:" FSK-ja çdo ditë e më tepër po i rrit kapacitetet e saj operacionale dhe ne jemi të interesuar që të avancohet misioni, detyrat dhe furnizimi me pajisje të avancuara".

Për kryetarin e Komisionit ishte mbresëlënëse puna e pjesëtarëve të kësaj force, e cila siç u shpreh ai garanton pjesëmarrje të suksesshme në misione jashtë vendit. Ai ndër të tjera nuk la pa përmendur edhe raportet e shkëlqyeshme që ka ky Komision me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ndërsa, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli tha që nuk është hera e parë që ky komision viziton FSK-në dhe përcjell për së afërmi aktivitetet e saj. Kjo dëshmon edhe një herë bashkëpunimin e mirë në mes të FSK-së dhe Komisionit për Siguri dhe Mbikëqyrje të kësaj force.

Gjenral Hazrolli e njoftoi Komisionin edhe për përgatitjet që po bënë togu i FSK-së me rastin e pjesëmarrjes në ngjarjen e madhe të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ai u shpreh i kënaqur me punën e pjesëtarëve të togut të cilët do ta përfaqësojnë FSK-në në këtë manifestim.

Kurse nënkryetari i Komisionit Parlamentar për Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Rexhep Selimi tha: "Me gjithë sfidat që i ka kaluar FSK-ja ajo ka çka t'i tregojë dhe ofrojë popullit të saj si ushtri e ardhshme e Kosovës. Ai shtoi se ekzistojnë mundësi dhe kapacitete që Parlamenti i Kosovës të bëjë më tepër për FSK-në. Sot nuk jemi pjesë e mbikëqyrjes, por jemi pjesë e suksesit të FSK-së" përfundoi Selimi.

Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së bënë vizita periodike në MFSK dhe FSK.

Diplomojnë 27 pjesëtarë të FSK-së, në Kursin e udhëheqësve luftarakë

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, ditë më parë u bë ceremonia e diplomimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kanë ndjekur "Kursin e udhëheqësve luftarak", nga instruktorët amerikanë dhe ata të FSK-së.

Në ceremoninë e diplomimit morën pjesë komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFT-së, gjeneral-major Rrahman Rama dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati, pasi përshëndeti pjesëtarët e FSK-së, shtoi: "Kursi i udhëheqësve luftarak i organizuar dhe i mbajtur në bashkëpunim me instruktorët e Akademisë së Nënoficerëve të SHBA-së, të mbështetur edhe nga instruktorët tanë, është edhe një arritje e radhës e FSK-së, në ngritjen dhe zhvillimin e kanalit mbështetës të nënoficerëve.

Ky kurs i realizuar me grupin e dytë të nënoficerëve tanë, në kuadër të bashkëpunimin dypalësh në mes të FSK-së dhe SHBA-ve, tregon mbështetjen dhe përkushtimin e vazhdueshëm të SHBA-së, për FSK-në dhe për Kosovën në përgjithësi". Në mesin e kadetëve të diplomuarëve, ishte edhe një pjesëtarë i Ushtrisë shqiptare.



Pastaj, komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati, iu drejtua pjesëtarëve të sapo certifikuar: "Të nderuar kursant, ky kurs do t'ju ndihmojë në aftësimin e mëtejshëm për të udhëhequr grupet e vogla të ushtarëve, me theks të veçantë në aftësitë drejtuese, si në udhëheqje dhe në menaxhim të trajnimit taktik. Përfundimi i këtij kursi, ua ka hapur rrugën për t'u bërë nënoficerë të suksesshëm, bazuar në vlerat që e mishërojnë një udhëheqës, si: vetëzhvillimi, stërvitja dhe motivimi i ushtarëve, duke u shërbyer dhe udhëhequr me shembullin personal, me zhvillimin e përvojave për të ngritur dhe mbajtur standardet më të larta, kujdesin për ushtarët tuaj dhe aftësitë tuaja, për të vepruar më së miri në situatat që mund t'ju ndodhin.

Ky trajnim është hapi i parë i juaj, në rrugën e gjatë dhe të vështirë të zhvillimit si nënoficer profesionist, si dhe pika e fillimit për ndërtimin e arsimit profesional dhe themelit për të ardhmen dhe karrierën tuaj. Teknikat dhe procedurat e mësuara gjatë këtij kursi, do të jenë bazë për suksesin tuaj.

Gjatë këtyre javëve, ju keni marr shkathtësi të cilat rrisin më tutje kapacitetet e FSK-së. Unë si Komandant i FSK-së, pres që këto shkathtësi t'i bartni me sukses tek pjesëtarët tjerë, në njësitë tuaja".

Në fund, gjeneral Kastrati falënderoi Ambasadën amerikane, ekipin e instruktoreve amerikanë dhe ekipin e instruktoreve tanë, për angazhimin maksimal në realizimin me sukses të këtij trajnimi shumë të rëndësishëm për FSK-në.

Ndërsa instruktori Dustin French, në fjalën e tij tha:"Gjatë këtij trajnimi të diplomuarit kanë mësuar aftësitë bazike për të qenë nënoficerë të mirë".

Trajnimi dhe përgatitja fizike, këshillimi, menaxhimi, lëvizjet taktike janë disa prej njohurive të fituara gjatë ndjekjes së këtij kursi.

Dustin French, ju drejtua të diplomuarve, me këto fjalë: " Ju sot, do të shkoni në njësitë tuaja dhe t'i udhëhiqni ushtarët. Duhet ta dini se jeni pjesë e një hapi të madh për njësitet tuaja. Me komplet timin e këtij kursi, ju do të përforconi trajnimet për nënoficerët e ardhshëm të FSK-së. Ju duhet të jeni krenar që jeni pjesë e këtij trajnimi. Kur të ktheheni në njësitet tuaja vazhdoni t'i përgatitni edhe ushtarët tuaj që një ditë të jeni nënoficerë të mire".

Edhe rreshter majori Selles, ka dhënë komplimente për aftësitë e treguara profesionale të kursantëve si dhe për gradimin dhe gatishmërinë e tyre për të marrë detyra të reja.

Në fund u ndanë mirënjohje për më të mirët, si mirënjohja "ushtar i dalluar", e cila iu dha ushtarit më të mirë, pastaj "Çmimi i Listës së Komandantit" iu nda ushtarit i cili ka demonstruar paraqitje të shkëlqyeshme, si dhe çmimi "Njeriu i Hekurt" ushtarit i cili ka tejkaluar standardet duke shfaqur epërsi fizike dhe mendore gjatë kursit të liderit luftarak.



FSK-ja dhe Ushtria Shqiptare marshojnë së bashku për 28 Nëntor

Me krenari dhe përkushtim që do ta përfaqësojnë vendin e tyre në 100- vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, 63 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka më shumë se dy muaj që janë duke u përgatitur për këtë ditë, në mënyrë që përfaqësimi i tyre të jetë sa më i denjë përkrah Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë .

Për nder të ditës së Flamurit dhe 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, Forca e Sigurisë së Kosovës ka filluar të stërvitë një kuadrat të formuar enkas për nder të 28 Nëntorit, i cili do t'i vazhdojë stërvitjet deri pak ditë para kësaj date. Pjesëtarët janë duke u stërvitur në pjesën fizike e cila do të ndihmojë shumë në qëndrueshmërinë e tyre gjatë trajnimit këtu dhe gjatë marshimit atje. Dhe, në perfeksionimin e drillit, lëvizjeve të rregulloreve rreshtore që ata të jenë të bashkërenduar në hap me njëri-tjetrin dhe të kenë një përputhje të plotë të lëvizjeve gjatë marshimit. Gjatë këtyre javëve të trajnimit, pjesëtarët kanë arritur një standard të dëshirueshëm fizik dhe të rregullores rreshtore.

Në bazë të urdhëresës së Komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë është bërë përzgjedhja e 63 pjesëtarëve të përbërë nga batalionet e BRSH-së. Në kuadër të këtij numri janë të përfshirë 2 oficerë, 2 nënoficerë dhe 59 ushtarë. Po ashtu 11 nga këta pjesëtarë janë të gjinisë femërore. Ata janë përzgjedhur në bazë të disa standardeve, kryesisht të atij të gjatësisë, 180cm për meshkuj dhe së paku 170cm për femra, si dhe nga përgatitja e tyre fizike.

Gjatë kësaj kohe është organizuar një trajnim i ngarkuar, ku pjesëtarët krahas stërvitjes fizike që është primar për qëndrueshmërinë e tyre, ata po ashtu në perfeksionimin e drillit, lëvizjeve të rregullores rreshtore, ata trajnohen që të kenë një koordinim të hapit dhe të lëvizjeve të tjera të kokës dhe drillit me pushkë.

Vijon në faqen 5

Intervistë me major Agron Spahiun, zëvendëskomandant i Batalionit të Parë të BRSH-së në Gjilan

Batalioni i Parë i BRSH-së dallohet për arritjet e rezultateve profesionale



Profesionalizmi në rritje përditë e më shumë e karakterizon Batalionin e Parë të BRSH-së, në Gjilan.
Forca e Sigurisë së Kosovës është vlerësuar lart në ushtrimet që pjesëtarët e saj kanë marrë pjesë si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Gjë që, është një tregues i besueshëm se jemi në rrugën e duhur për të qenë tërësisht profesional.
Ky nivel i arritur nuk është spontan, por është reflektim i punës së palodhur dhe eksperiencës së udhëheqësit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.
Një rol vendimtar në këto vlerësime pozitive që përmendëm më lart, zë edhe performanca e personelit të Batalionit të Parë, në Gjilan.
Për këtë qëllim vizituam këtë Batalion dhe për t'i kuptuar më mirë për zhvillimet e tërësishme të tij, biseduam me zëvendëskomandantin, major Agron Spahiun. (komandanti i Batalionit, nënkolonel Agron Bajrami, ndodhet për një trajnim në SHBA).

Zotëri major; Cili është, më saktë, Batalioni i Parë, që ju e udhëhiqni?
Batalioni i Parë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH) i ka katër Kompani. Batalioni vepron sipas direktivës së Komandantit të BRSH-së, gjeneralbrigade Nazmi Brahimaj, udhëzuesit të Komandantit të Batalionit si dhe planit vjetor-mujor, të përgatitur nga Komanda e Batalionit. Trajnimet e brendshme të Batalionit mbahen nga instruktorët e saj të licencuar nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) dhe KFOR-i, me të cilin ka bashkëpunim të mirë. Batalioni i Parë është dalluar për arritjen e rezultateve në trajnime, qoftë brenda dhe jashtë vendit, si: në Amerikë, Turqi, Maqedoni, etj.
Ka kohë që një kontingjent po përgatitet për të marrë pjesë më 28 Nëntor, në Tiranë, në përvjetorin e 100 të Pavarësisë. Të gjithë pjesëtarët e këtij Batalioni dallohen në kryerjen e detyrave të përditshme, qoftë, në trajnime, shkollim, kurse, mësimin e gjuhëve etj.
Batalioni i Parë, të cilin e udhëheqi unë, ka stafin e Batalionit S1-S4, katër kompani, tri janë operacionale dhe një mbështetëse. Profesionalizmi është në rritje, që përditë e më shumë e karakterizon Batalionin e Parë të BRSH-së, në Gjilan. Batalioni është vlerësuar lart në ushtrimet, që pjesëtarët e saj, kanë marrë pjesë në trajnime si brenda dhe jashtë shtetit. Ky është një tregues i besueshëm se jemi në rrugën e duhur për të qenë tërësisht të profesionalizuar. Ky nivel i arritur nuk është spontan, por është reflektim i punës së palodhur dhe eksperiencës së lidershipit të Batalionit. Një rol vendimtar në këto vlerësime pozitive që përmendëm më lart, zë performanca e personelit të Batalionit të Parë, me zhvillimet dhe të arriturat e saj, të deritashme. Pjesëtarët e Batalionit të Parë, kanë një qasje pozitive, për të dhënë maksimumin gjatë trajnimeve si brenda dhe jashtë vendit, me qëllim, realizimin e misionit të saj. Harmonia dhe disiplina janë në nivelin më të lartë.

Zotëri major; Kohëve të fundit, Batalioni i Parë, ka arrit rezultate lakmuse gjatë ushtrimeve, ç'mund të na thoni për këtë vlerësim?
Kryerja e ushtrimeve/trajnimeve, për çdo ushtarak konsiderohet një vlerësim për punën dhe përkushtimin në kryerjen me sukses të detyrave të ngarkuara. Kjo për mua është e rëndësishme dhe me peshë të madhe.
Batalioni i Parë gjithkund ku ka marrë pjesë, si në ushtrime në nivel të FSK-së, siç ishte ushtrimi fushor "Shqiponja-1"(ushtrimi më i madh i FSK-së), ushtrimet e brendshme që i organizon vetë Batalioni, si; ato individuale dhe ato kolektive dhe në trajnime në KDS, ka treguar rezultate të mira.
Këta djem dhe vajza me uniformën e FSK-së, çdo ditë e më tepër, me punën dhe përkushtimin e tyre po shkojnë drejt profesionalizimit, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktiko-profesional, duke i qëndruar gjithmonë besnik misionit që kanë.
Për arritjet e deritanishme, kanë merita të gjithë ushtarët, nënoficerët dhe oficerët që punojnë këtu. Batalioni ynë është shembull i respektimit të detyrave dhe misionit që ka. Në këtë batalion janë të angazhuar edhe shumë pjesëtarë të komuniteteve tjera, si: serbë, boshnjakë, turq, ashkalinjë etj. Harmoninë mes tyre dhe disiplina kanë bërë që ky batalioni të arrijë rezultate të përgjithshme. Këtu, të gjithë dallohen për punën e madhe si dhe për angazhimin profesional, duke filluar nga ushtarët, nënoficerët dhe oficerët.

Zotëri major; Batalioni i Parë, dallohet prej të tjerëve, edhe për pjesëmarrjen e pjesëtarëve të komuniteteve?
Në Batalionin e Parë, sipas strukturës, ka mbi 56 pjesëtarë të komuniteteve. Ky është një shembull i mirë. Të gjithë pjesëtarët e komuniteteve, si: serbë, boshnjak, turq, ashkalinj, etj. dallohen me përkushtimin e tyre në kryerjen e detyrave të



përditshme. Harmonia dhe disiplina, në mes të gjithë pjesëtarëve, ka bërë që Batalioni të arrij rezultate të shkëlqyeshme.

Batalioni i Parë gjatë këtij viti, ka marrë pjesë në shumë ushtrime të rëndësishme, si: në Amerikë, Turqi, Maqedoni, etj, çfarë mund të na thoni për këtë?
Një prej kompanive operacionale të Batalionit është edhe Kompania 1A (K1A) e cila është kompani model e Batalionit. Kjo kompani është trajnuar për misione të ndryshme e në veçanti për operacione në kriza si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kjo kompani e Batalionit ka qenë e angazhuar në shumë stërvitje, qoftë brenda dhe jashtë Kosovës; në Amerikë, në Turqi si dhe ka pasur një dislokim, në Maqedoni, ku vlen të theksohet se ky ka qenë dislokimi i parë i FSK-së, në nivel kompanie, ku është vlerësuar shumë lartë. Në këto trajnime, pjesëtarët e Batalionit tonë, kanë treguar rezultate, por edhe në të njëjtën kohë kanë përfituar shumë, në aspektin profesional. Në trajnimet në Amerikë, në Turqi dhe në Maqedoni, drejtpërdrejt nga ana jonë trajnimet i ka udhëhequr major Berat Shala, por unë si zëvendës komandant i kam përcjellë nga afër ushtrimet dhe plotësisht jam i kënaqur për këto të arritura, në nivelin e jashtëm.
Gjithashtu pjesëtarët (nënoficerët) e Batalionit kanë marrë pjesë edhe në trajnime në bazën Amerikane, në Gjermani. Pjesëtarët tanë kanë marrë pjesë edhe në maratonën tradicionale në Holandë, ku kanë treguar rezultate të mira.
Ne kemi një bashkëpunim të mirë me KFOR-in, ku në kuadër të bashkëpunimit jemi duke zhvilluar trajnim me ekipin Turk, Grupin e Perëndimit Villagge Italia si dhe me Grupin e Lindjes Bonsteel.
Batalioni i Parë në kuadër të trajnimeve dhe operacioneve ka realizuar gjatë këtij viti dy marshime kondicional-taktike si dhe dy herë vrapim 10 km, si dhe testimin fizik, për çdo pjesëtarë të Batalionit.

Zotëri major; Cili është bashkëpunimi me strukturat komunale, dhe të tjera?
Ne kemi një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat politike të komunave në territorin ku bënë pjesë Batalioni ynë. Ne kemi takime pune të dyanshme, me kryetarët e komunave, gjithashtu bashkëpunim kemi edhe me Policin e Kosovës, Organizatat Joqeveritare, me mediat, shkollat, etj.
Vlen të theksoj, se një bashkëpunim të veçantë e kemi me KFOR-in, Lindje.

Zotëri major; Si zëvendëskomandant i Batalionit të Parë, cili është vizioni juaj për të ardhmen, pra cilët janë objektivat, që ju i keni vënë vetes, për ta quar përpara Batalionin e Parë?
Po, është një fakt që Batalioni i Parë, ka arrit rezultate të mira, si brenda ashtu edhe jashtë
vendit dhe tashmë ka një eksperiencë të mirë, në këtë drejtim. Natyrisht që, synimi im është arritja e objektivave të caktuara nga Komandanti i Brigadës për përmbushjen e misionit, si dhe vazhdimi i konsolidimit dhe profesionalizmit të Batalionit në veçanti si dhe të FSK-së, në përgjithësi.







FSK-ja dhe Ushtria Shqiptare marshojnë së bashku për 28 Nëntor

Vijon nga faqja 3
Të njëjtën kohë ata janë duke praktikuar drillin e flamurtarit që do të ekzekutohet nga një pjesëtarë i gjinisë femërore.
Për udhëheqësin e kuadratit, togerin Faton Bekteshi, është nderë dhe privilegj që ta udhëheqë këtë kuadrat që do të parakalojë me ushtrinë shqiptare për nderë të kësaj feste. "Duke kujtuar sakrificën e të gjithë luftëtarëve, të cilët dhanë më të shtrenjtën e tyre për lirinë tonë, ndiej edhe një përgjegjësi shumë të madhe se si udhëheqës ta realizoj sa më mirë këtë detyrë. Po bëj përpjekje dhe do të mundohem të jap maksimumin në trajnim që ta ekzekutoj sa më mirë këtë detyrë të shenjtë për mua dhe shpresoj që parakalimi të jetë shumë i mirë dhe i një niveli të lakmueshëm.
Nëse para një dekade ishte vetëm një ëndërr të shkonim në Shqipëri, sot është një ndjesi shumë e mirë që po e realizojmë këtë ëndërr të kahershme të popullit shqiptar dhe po marrim pjesë me një kuadrat si forcë moderne krahas Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", u shpreh toger Bekteshi. Kurse detyra e rreshterit të Togut që do të defiloj në shënimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, përveç se është nderë dhe emocion është edhe më shumë përgjegjësi thotë Besnik Shala, i cili kujton kohën kur ai ishte pjesëtar i UÇK-së, më pas i TMK-së dhe tash si pjesëtar i FSK-së. "Në këtë paradë ushtarake të festave për nder të 100 vjetorit të pavarësisë, unë nuk përfaqësoj thjeshtë FSK-në apo zyrtarisht shtetin e Kosovës, por përfaqësoj edhe familjen time, shoqërinë, kolegët dhe gjithë popullin e Kosovës. Aty do të përfaqësoj gjakun dhe jetët e humbura të shokëve të UÇK-së, përfaqësoj ata shokë të tjerë që sot janë invalidë, të cilët sakrifikuan pjesë nga trupi i tyre për çështjen kombëtare. Gjithashtu do të mundohem të përfaqësoj ata veteran të UÇK-së, të cilët jam i bindur se ndjehen krenar për këtë ditë", shprehet rreshter Shala.
Ai po ashtu me shumë emocion tregon për të kaluarën e tij si ushtarak dhe realizimin e ëndrrës që në liri te këtë mundësinë të parakalojë së bashku me shumë ushtarë e sidomos me Ushtrinë Shqiptare për një ditë dhe një datë kaq të rëndësishme për gjithë historinë e popullit shqiptar.
"Ishte ëndërr e kahershme e imja dhe e shumë shokëve që të preknim tokën e nënës Shqipëri. Për shumë kohë vërtet ishte vetëm një ëndërr, por ishte ai brezi i artë i ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila e bëri realitet dëshirën dhe etjen tonë. Është kjo meritë e një ushtrie të tërë dëshmorësh që nga Isa Boletini e deri tek legjendari Adem Jashari.
Jam i privilegjuar që i takova UÇK-së, ushtrisë e cila bëri epokë të re. Sot jam krenar kur në rreshtat e ushtrisë sime, FSK-së, trashëgimtare e UÇK-së dhe TMK-së, do të marshojmë në "Sheshin e Dëshmorëve" në Tiranë përkrahë ushtrisë shqiptare"përfundon rreshter Besnik Shala.
Kuadrati i FSK-së që do të parakalojë në Tiranë përveç që udhëhiqet nga oficerë të FSK-së, ish-pjesëtarë të së kaluarës së lavdishme të UÇK-së ai përbëhet edhe nga të rinj dhe të reja të cilët me shumë dëshirë ju kanë bashkuar ushtrisë së ardhshme të Kosovës e ndër to është edhe ushtarja e re e Batalionit të lll në Gjilan,Naime Sfishta. Naimja nuk mund ta fsheh gëzimin, që është përzgjedhur në mesin e shumë vajzave të FSK-së, që të jetë pjesë e kuadratit që do të parakalojë për nderë të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë "Unë si pjesëtare e FSK-së dhe pjesëmarrëse në kuadrat jam shumë e privilegjuar dhe e nderua që të marrë pjesë në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Për mua kjo është krenaria më e madhe që kam përjetuar deri më tani, për arsye se po festojmë pavarësinë njëshekullore të popullit shqiptar. Pas shumë vuajtjesh e sakrificash të shumë vajzave dhe djemve, të cilët dhanë jetën për këtë ditë dhe për këtë tokë që të tundim këmbët pa frikë. Sot ne jetojmë të lirë dhe të lumtur me plotë krenari, duke kujtuar gjithmonë se ne jemi një popull që nuk e pranojmë nënshtrimin dhe luftojmë për idealet tona të lirisë. Prandaj ne jemi te bashkuar, jemi një popull dhe sot me shumë krenari do ta përfaqësojmë denjësisht Kosovën dhe flamurin, një ndjenjë e veçantë kjo për mua si pjesëtare e FSK-së" tha Sfishta.
Të gjithë pjesëmarrësit e këtij kuadrati shihen shumë të motivuar dhe po bëjnë një punë të palodhshme duke u stërvitur disa orë në ditë vetëm që të shkëlqejnë në ditën e 28 Nëntorit. Duke pasur parasysh trajnimet e ngarkuar me të cilat ata po ballafaqohen çdo ditë, mund të themi se vetëm motivi i lartë dhe përkushtimi i madh i shtyn ata të japin maksimumin nga vetja gjatë gjithë kohës për të arritur më të mirën e mundshme.
Stërvitjet përgatitore të 63 pjesëtarëve të FSK-së do të zgjasin deri pak ditë para datës së 28 Nëntorit.



Këshilli Danez për Refugjatë vazhdon ta ndihmojë Kosovën



Këshilli Danez për Refugjatë, në Kosovë, ka ndihmuar në ndërtimin e mbi 5000 shtëpive për të kthyerit, "shtëpi për refugjatë".
Ky këshill ka vepruar në Kosovë që nga viti 1998 dhe vetëm gjatë bombardimeve të NATO-s ka ndërprerë aktivitetin e vet, në vitin 1999.
"Fillimisht, Këshilli Danez për Refugjatë u fokusua në dhënien e ndihmave emergjente, por shumë shpejt u zgjerua edhe në mbështetje logjistike, transport, strehim dhe aktivitete të rindërtimit duke gjeneruar të ardhura për aktivitetet dhe rehabilitimin social të Qendrës për Monitorimin e Brendshëm të Zhvendosjes, refugjateve dhe popullatës së prekur nga lufta", na thotë që në fillim të bisedës sonë, zonja Kristen Stec zyrtare e KDR-së.
Ndërsa, nga viti 2003, Këshilli Danez për Refugjatë është përqendruar gjithnjë për kthimin e pakicave në Kosovë, një program me prioritet i cili është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me KDR-në, në Serbi dhe Mal të Zi. Detyrat janë përqendruar në krijimin e një procesi të qëndrueshëm të kthimit në Kosovë, përmes synimeve, jo vetëm për kërkesat fizike për refugjatët e kthyer dhe të zhvendosur, por edhe për aspekte tjera thelbësore, që kontribuojnë në një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm në të cilin do të jetojnë dhe të punojnë në periudha të rëndësishme gjatë tranzicionit. Këto, përfshijnë integrimin social, ekonomik dhe zhvillimin, përmirësimin e kushteve të jetesës, objektet dhe mundësitë për pranimin dhe kthimin e komuniteteve, sigurinë, dialogun ndëretnik, përkrahjen e vazhdueshme të grupeve të ndryshme të përfituesve duke marrë parasysh moshat e ndryshme, gjininë dhe çështje të veçanta etnike apo fetare. Puna ka vazhduar edhe në forcimin e organizatave të shoqërisë civile, fuqizimin dhe ndërtimin e kapaciteteve në mes autoriteteve lokale për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për përfituesit në Kosovë, si dhe aspektet psikike-sociale të shërbimeve të shëndetit mendor.
Këshilli Danez për Refugjatë, aktualisht është duke vepruar në Kosovë me zyrat rajonale, në Mitrovicë, Prizren dhe Prishtinë. Personeli vendorë prej 27 personave dhe dy ndërkombëtarë janë duke i realizuar 5 projektet aktuale në tërë Kosovën, të cilat janë të mbështetura nga Njësia Mbështetëse Qendrore me seli në Prishtinë.
Lista e projekteve aktuale është realizimi nga UNHCR-ja, për mbështetjen e të zhvendosurve nga Kosova, në procesin e vendimmarrjes drejt një zgjidhje dinjitoze, nga Bashkimi Evropian siç është Projekti i Regjistrit Civil.
Një projekt tjetër i veçantë është edhe projekti i organizuar nga SIDA, i ashtuquajturi Stabilizimi i Komuniteteve në Mëhallën e Romëve.
Një kontribut në këtë drejtim ka dhënë edhe Ambasada Britanike dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, Kthimi i Qëndrueshëm për qytetin e Prizrenit dhe SMB (Bordi i Migracionit Suedez),mbështetje për kthim të qëndrueshëm në Kosovë dhe Serbi të azilkërkuesve refuzuar nga Suedia.
Ky këshill ka një bashkëpunim të mirë me Forcën e Sigurisë së Kosovës.
"Me FSK-në kemi realizimin e një projekti të përbashkët: pastrimin e mjedisit(ambientit) nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera, të shtëpive në Mitrovicë dhe të qyteteve të tjera të Kosovës, me qëllim që të kthyerit të jenë të sigurt në mjediset e tyre",thotë zonja Stec
Ndërsa drejtori i Departamentit të BCU-së, Hajrush Kurtaj i ka konfirmuar takimet punuese dhe bashkëpunimin që ka me Këshillin Danez për Refugjatë." Ne kemi një bashkëpunim të mirë, ky bashkëpunim ka ekzistuar edhe më parë, me TMK-në dhe po e vazhdojmë edhe tani.
Po mundohemi që me njësitet profesionale të FSK-së, sidomos me njësitet e çminimit dhe të MKABK-së të kontribuojmë në pastrimin e shtëpive të të kthyerve-refugjatëve, nga mjetet e pashpërthyera dhe të rrezikshme, me qëllim që njerëzit e shpërngulur të kthehen lirshëm dhe të sigurt në shtëpitë e tyre.
Këshilli Danez për Refugjatë, (DRC) në Kosovë është duke i realizuar edhe pesë projekte të tjera të rëndësishme".

FSK-ja e bën me shtëpi familjen Haziri



Pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në organizim të Departamentit Civil-Ushtarak të MFSK-së dhe në bashkëpunim me Komunën e Istogut, kanë kryer ndërtimin e shtëpisë (72metra katrorë) për familjen e Osman Hazirit, katër anëtarësh, nga fshati Dragolevc i Istogut.
Me rastin e përurimit të shtëpisë, komandanti i Batalionit të Xhenios, major Mehdi Maloku u shpreh i kënaqur për ndërtimin e shtëpisë për familjen Haziri, e cila jetonte në kushte të vështira, si dhe për bashkëpunimin e mirë të FSK-së me komunën e Istogut, në realizimin e këtij projekti humanitar. Njëherësh ai shprehu gatishmërinë e FSK-së, që edhe në të ardhmen të realizojnë projekte të tilla humanitare.
Kryetari i komunës së Istogut Haki Rugova, tha :"Gatishmëria dhe prezenca e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës ishte jashtëzakonisht e rëndësishme si për komunitetin po ashtu edhe për punën që kanë kryer pjesëtarët e FSK-së"
Ndërsa në fund kryefamiljari Osman Haziri duke falënderuar të gjithë ata që ndihmuan në ndërtimin e shtëpisë së tij tha: "Pa punën dhe mundin e pjesëtarëve të FSK-së, iniciativën e KFOR-it dhe donacionin e Komunës së Istogut, kjo shtëpi nuk do të ishte ndërtuar dhe për këtë shpreh falënderimin e veçantë në emër të familjes sime, për të gjithë ata që na ndihmuan e në veçanti për Batalionin e Xhenios të FSK-së.
Për kontributin e dhënë në ndërtimin e shtëpisë së Osman Hazirit, Komuna e Istogut u dha mirënjohje të gjithë pjesëtarëve të Batalionit të Xhenios, për angazhimin e tyre në realizimin e këtij projekti humanitar.

Në ceremoninë e pranimdorëzimit të çelësave, morën pjesë, drejtori i Departamentit Civil-Ushtarak të Ministrisë së FSK-së, Hajrush Kurtaj, si dhe oficerë të lartë të FSK-së, nga Komanda e Forcave Tokësore, Batalioni i Xhenios dhe zyrtarë të lartë të Komunës së Istogut.

Pjesëtarë të minoriteteve në FSK prononcohen për gazetën "Forca Jonë"



Toger Jaser Mulla: FSK-ja vazhdon ngritjen profesionale sipas parimeve të Gardës Nacionale të Ajovës

Jaser Mulla është komandant i Togut të tretë, Kompania-A, në Batalionin e Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së në Gjilan. Me përkatësi është boshnjak.

Ka kryer akademinë në Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së dhe në Universitetin Amerikan në Prishtinë, drejtimi Menaxhment dhe politika publike.

Jaseri ka kryer edhe një trajnim njëvjeçar në Akademinë e Mbretërisë së Bashkuar në Angli, ku është dalluar për përkushtimin dhe për arritjen e rezultateve të shkëlqyeshme.

"Unë me përkatësi jam boshnjak. Marrëdhëniet në mes të pjesëtarëve të komuniteteve këtu janë të shkëlqyeshme dhe nuk ka diskriminim. Asnjëherë nuk ka pasur probleme të kësaj natyre dhe për këtë jam shumë i kënaqur. Andaj me vullnet jam duke i realizuar të gjitha mësimet që i kam mësuar në akademi, me qëllim që t'i përcjelli tek pjesëtarët e FSK-së. Kushtet këtu janë shumë të mira dhe të volitshme për punë, për trajnime dhe për aktivitete të tjera.

Kazerma jonë i plotëson edhe të gjitha kushtet teknike. Mund të veçoj ushtrimin në Maqedoni dhe në Turqi, ku ishim si "Task-Forcë". Qëllimi i këtij ushtrimi ishte përgatitja e FSK-së për misione paqeruajtëse.

Këtë vit kemi sjellë risi në ushtrimet e FSK-së, në krahasim me trajnimet e mëparshme. Jemi duke zhvilluar trajnime të reja, të cilat i kemi ushtruar praktikisht në Gardën Nacionale të shtetit të Ajovës në SHBA.

Me Gardën e Ajovës kemi marrëdhënie të mira. Disa oficerë të Ajovës për momentin janë në njësinë tonë, ku po kontribuojnë në përgatitjen profesionale të njësive të FSK-së".

Në fund, toger Mulla u shpreh më se i lumtur se marrëdhëniet në mes të komuniteteve që veprojnë janë shembull i mire dhe se FSK-ja po ecën me hapa të sigurt drejt profesionalizmit të saj.



Boban Maksimoviq u bënë thirrje bashkëkombëseve të tij për aplikim në FSK

"Marrëdhëniet janë të shkëlqyeshme, nuk ka dallime racore dhe ngjyre, të gjithë jemi të barabartë, secili i kryen detyrat me përgjegjësi në FSK"-ishin këto fjalët e para të Boban Maksimoviqit me përkatësi serbe, gjatë intervistës që bëmë me pjesëtarët minoritarë që veprojnë në Batalionin e Parë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Gjilan.

"Jam prej fillimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht, në Togun e Parë të Kompanisë së Parë. Kam kryer trajnimet përkatëse si të gjithë pjesëtarët e tjerë të FSK-së. Në Togun e Parë e kryej detyrën e administratorit. Në këtë detyrë kam një përvojë të mirë, sepse të njëjtën detyrë e kam kryer edhe në ish-Trupat e Mbrojtjes të Kosovës (TMK). Të gjitha detyrat i kryej me përgjegjësi dhe në përputhje me rregulloret e FSK-së. Ndjehem jashtëzakonisht i lumtur që jam pjesëtar i FSK-së.

Në FSK të gjithë angazhohemi maksimalisht dhe me përgjegjësi të lartë për kryerjen e detyrave të parashtruara nga eprorët tanë. Këtu nuk ka dallime, nuk ka emra, këtu të gjithë jemi ushtarë ose eprorë. Bashkëpunimi në mes të pjesëtarëve të FSK-së është i shkëlqyeshëm. Askujt nuk i shkon ndërmend të thirret në baza nacionale. Unë jam i kyçur që prej fillimit në radhët e FSK-së dhe kurrë s'kam pasur as problemin më të vogël me pjesëtarët e të tjera nacionaliteteve. Këtu nuk ka dallime kombi, ngjyre e feje".

Kamë punuar edhe më parë në kuadër të TMK-së, ndërsa tani jam në FSK, ku kam arritur që t'i përshtatem rrethanave të reja falë trajnimeve në Ferizaj dhe në Istog. Edhe gjatë kryerjes së trajnimeve në Ferizaj dhe Istog, jo vetëm unë si pjesëtar i komunitetit serb, por edhe pjesëtarët e komuniteteve tjera si: boshnjakë, ashkalinjë, turq etj, asnjëherë nuk kemi pasur probleme. Unë jam oficerë me gradën tetar. Jeta këtu është shumë aktive, përveç punëve të përditshme merremi edhe me aktivitete sportive, sidomos jam adhurues i futbollit dhe i volejbollit. Kushtet për kryerjen e këtyre aktiviteteve janë shumë të mira, me fusha përkatëse sportive.

Këtu, në Gjilan në njësitet tjera të FSK-së ka edhe shumë pjesëtarë të tjerë të komunitetit serb".

Në fund të intervistës, tetari Boban Maksimoviq, u bënë thirrje bashkëkombëseve të vet që të aplikojnë sa më shumë në FSK, sepse bashkëpunimi dhe mirëkuptimi, këtu, janë në nivelin më të lartë dhe që të gjithë janë të barabartë, pa dallime nacionale, fetare dhe racore.



Toger Sadik Hyzeir: Këtu nuk ka dallime; a je turk, boshnjak, ashkali, serb apo shqiptar!.

Toger Sadik Hyzeiri është pjesëtar i FSK-së nga radhët e komunitet turk, i cili vepron në Kompaninë e Parë në Gjilan.

Toger Hyzeiri: "Raportet në mes pjesëtarëve janë në nivelin më të mirë, këtu nuk ka dallime; a je turk, boshnjak, ashkali, serb apo shqiptar!.

Bashkëpunimi është i shkëlqyeshëm në mes pjesëtarëve të të gjitha nacionaliteteve. Me përgjegjësi mund të them se secili po jep kontributin e vet në ndërtimin e FSK-së. Jam këtu që tri vite dhe të them të drejtën nuk ka asnjë rast diskriminimi për shkak të ngjyrës apo racës, të gjithë jemi një dhe detyrat i kryejmë me përgjegjësi të plotë".

Sadiku ka kryer trajnime të shumta profesionale edhe jashtë vendit, si në Amerikë etj.

"Unë jam komandant Togu, me 28 pjesëtarë të të gjitha nacionaliteteve. Bashkëpunimi në mes nesh është i shkëlqyeshëm, bisedojmë dhe këshillohemi me të gjithë pjesëtarët për punën profesionale, për kryerjen e detyrave me përgjegjësi, sepse secili prej nesh i din synimet tona të përbashkëta dhe qëllimi ynë është arritja e finalizimit dhe profesionalizimit të njësisë.

Unë nga SHBA-ja po mundohem që mësimet e mësuara t'i barti me sukses në Togun tim. Ka detyra të reja dhe shumë interesante që jemi duke i mësuar. Të gjithë punët po i kryejmë me përgjegjësi, pa dallim se cilit komunitet i takojmë.

Marrëdhëniet në Togun tonë dhe në përgjithësi janë të shkëlqyeshme, kjo shihet edhe gjatë kryerjes së aktiviteteve të lira, në shumë lëmi sportive si në futboll, volejboll, tenis e të tjera.

Te ne punët shkojnë mirë, por është më interes që pjesëtarët e rinjtë t'ju përshtaten sa ma shpejtë rrethanave dhe kryerjes së aktiviteteve në njësitë tona"

Gjithashtu edhe Hyzeiri u bën thirrje pjesëtarëve nga radhët e minoriteteve, që të aplikojnë për t'u bërë pjesëtarë të FSK-së.

Orkestra frymore e FSK-së me një të ardhme të mirë





Nënoficeri Martin Grace dhe rreshteri Steve Bacon, janë anëtarë të Bandës Ushtarak të Marincave Mbretërorë të Britanisë së Bashkuar, të cilët kanë kohë që po qëndrojnë në FSK, për ta ushtruar Orkestrën frymore të FSK-së, me qëllim të përgatitjes profesionale për Ditën e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK).

Kërkesës sonë për një intervistë të shkurtër, nënoficeri Martin Grace dhe rreshteri Steve Bacon, iu përgjigjen me dëshirë të madhe, edhe përkundër ditës së tyre mjaft të ngarkuar me ushtrime në Orkestrën frymor të FSK-së.

" Qëllimi kryesor i vizitës sonë, këtu në Kosovë, është që të punojmë në përgatitjen e Orkestrës frymore të FSK, për paraqitjen e saj sa më të mirë në Ditën e FSK-së dhe në koncerte të tjera të ndryshme.

Trajnimi ka qenë shumë frytdhënës , edhe pse dita gjatë ushtrimeve ka qenë shumë e ngarkuar. Kur kemi filluar ushtrimet, Orkestra frymore e FSK-së ka ditur të ekzekutojë vetëm dy këngë duke qëndruar statik, ndërsa tani ka mësuar shumë këngë dhe din të luajë dhe të marshojë në të njëjtën kohë. Po ashtu kemi rritur disiplinën e përgjithshme ushtarake dhe mënyrën e dukjes së pjesëtarëve të orkestrës .

Pas ushtrimeve të shumta me sukses e kemi kaluar provën përfundimtare, më datën 28 tetor në Kazermën "Adem Jashari", këtu në Prishtinë. Koncertin final, përkatësisht, provën profesionale e kanë përcjellë nga afër komandanti i FSK-së, gjeneral Kadri Kastratit dhe zëvendësambasadori UK Joe Preston.

Orkestra frymore e FSK-së, e ka kaluar testin provues dhe tani më është e përgatitur profesionalisht për të luajtur dhe për të marshuar në të njëjtën kohë.

Nënoficer Martin Grace dhe rreshteri Steve Bacon janë shumë të kënaqur me punën që kanë bërë me Orkestrën frymore të FSK-së: Të gjithë anëtarët e orkestrës kanë punuar jashtëzakonisht shumë. Ka qenë shumë e këndshme përfshirja e të gjithëve në këtë ngjarje. Orkestra frymore është një pasuri e shkëlqyer e FSK-së me potenciale të shumta.

Ne kemi besim se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen. " Shpresoj që kjo marrëveshje në mes Orkestrës frymore të FSK dhe Bandës së Marincave Mbretërorë të Britanisë së Bashkuar të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Shpresojmë që në të ardhmen, Orkestra frymore e FSK-së, do të bëhet edhe me profesioniste dhe do të jetë krenaria e Kosovës.

Në pyetjen tonë të fundit se me cilat përshtypje po largoheni nga Kosova?

Nënoficeri Martin Grace u shpreh:" Neve na kanë pritur shumë mirë në FSK i tërë grupi. Në Kosovë kemi krijuar miqësi të reja të cilat shpresojmë t'i vazhdojmë edhe në të ardhmen".



FSK-ja merr pjesë në marshin tradicional të organizuar nga kontingjenti danez i KFOR-it

Kontingjenti ushtarak danez, që vepron në kuadër të KFOR-it, gjatë kësaj fundjave, ka organizuar një marshim mbi 26 kilometra të gjatë, ku kanë marrë pjesë mbi 600 pjesëtarë të shumë përfaqësuesve të ushtrive që veprojnë në kuadër të KFOR-it në Kosovë.

Në këtë marshim, me ftesë të KFORIT danez, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza të FSK-së..

Marshimi i KFOR-it danez është bërë tradicional që nga viti 1972, me rastin e stacionimit të ushtareve danez në Qipro, ndërsa



në fundin e viteve të 90-ta kontingjenti danez filloj t'i ftojë edhe përfaqësuesit e organizatave ushtarake ndërkombëtare të cilat vepronin në ato zona veprimi.

Edhe në Kosovë është bërë traditë që në marshim të marrin pjesë përfaqësuesit e Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza (NJNRK) të FSK-së.

Njësia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza e FSK-së, ka një bashkëpunimin të shkëlqyeshëm dhe të drejtpërdrejt me kontingjentin danez. Falë këtij bashkëpunimi kjo njësi kohë më parë ka marrë pjesë në një trajnim në Danimarkë, me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes së Danimarkës, e cila e ka mbështetur me donacione dhe pajisje të tjera FSK-në.

Gjatë kësaj fundjave është thyer rekordi i pjesëmarrësve në marshim tradicional, ku rreth 600 pjesëmarrës kanë përfunduar me sukses në kohën e caktuar 25.85 km.

Njësia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza e FSK-së, ka marrë pjesë me 8 pjesëtarë,të cilët me sukses kanë arritur ta përfundojnë marshimin përkrahë kolegeve të tyre të KFOR-it.

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS
FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS

DITA E FORCËS

Me Forcën. Për Kosovën.

Nëntor, 2012

PËRMBAJTJA

MISIONI I MINISTRISË PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS 04

OBJEKTIVAT E FSK-SË PËR PERIUDHËN 2012-2013 04

MISIONI I FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS 04

PROGRAMI SHTETËROR I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET AJOVËS DHE KOSOVËS .. 06

KAPACITETET OPERACIONALE TË FSK-së 06

STRUKTURA E FSK-së 07

INFRASTRUKTURA (KAZERMAT E FSK-së) 07

NDIHMA KËSHILLIMORE E NATO-s DHE KFOR-it 08

TRAJNIMET DYPALËSHE NË KOSOVË DHE JASHTË SAJ 09

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES 09

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR - RRUGË DREJT INTEGRIMEVE EURO-ATLANTIKE 10

MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT 12

OPERACIONET E NJËSIVE TË SPECIALIZUARA TË FSK-së 12

FSK-ja NË INICIATIVAT RAJONALE 13

FSK-ja ME NJËSI TË TASK-FORCËS SË KËRKIM-SHPËTIMIT 13

FSK-ja REALIZON SHUMË PROJEKTE NË SHËRBIM TË QYTETARËVE 14

DEMINERËT KANË PASTRUAR MBI SHTATËQINDMIJË METRA KATRORË SIPËRFAQE TË MINUARA 16

RISHIKIMI STRATEGJIK I SEKTORIT TË SIGURISË 17

RRITET INTERESIMI I PJESËTARËVE TË KOMUNITETEVE PËR FSK-në 17

SHKALLË E LARTË E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË MFSK 18

UNIFORMA E RE E FSK-së 19

FORCA JONË

Viti I • Edicion special
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Botues: *Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës*
Adresa: *MFSK, Lagja Emshir, Prishtinë*
Adresa elektronike: *informimi.mfsk@gmail.com,*
Tel: *038/551-379*
Web: *www.mksf-ks.org*

Fjala e Botuesit për revistën "Forca Jonë", 26.11.2012

Editorial: *Me Forcën. Për Kosovën.*

Botimi i numrit festiv të revistës ***"Forca Jonë" përkon, më 100 Vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.*** 27 Nëntori - Dita e **FSK-së**, nis me moton: ***Me Forcën. Për Kosovën***.

Data e 27 Nëntorit shënon vitin e katërt të themelimit të FSK-së. Kjo datë e gjen MFSK-në dhe FSK-në me rezultate të shumta, që ka arritur në kryerjen e detyrave dhe realizimit të objektivave, sipas planifikimit të dinamikës së ngritjes dhe të zhvillimit.

Numri i shtatë i revistës ***"Forca Jonë"*** është numër festiv, dhe ju sjellë arritjet vjetore të M-FSK-së, në shumë fusha, që ishin objektiva të Ministrit Agim Çeku dhe Komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati.

Në këtë numër janë të pasqyruara arritjet nga fushat e shumta: bashkëpunimi ndërkombëtar, profesionalizimi dhe ngritja e FSK-së, janë disa nga faktorët, që sot kjo forcë ka arrit imazhin dhe besueshmërinë më të madhe, në Kosovë. Kjo u bë, me krijimin e identitetit të ri të FSK-së, përmes emërimit të kazermave, shenjave dhe emblemave si dhe uniformës të re. Imazhi i FSK-së, rritet edhe përmes dinamikës dhe profesionalizimit në: trajnime, ushtrime fushore, bashkëpunimit civilo-ushtarak, dhe me pjesëmarrjen në aktivitetet e karakterit ndërkombëtar e regjional. Për thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, një rol të rëndësishëm po luajnë nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me shtetet fqinje, rajonit dhe botërore, emërimi i atasheve ushtarak të FSK-së, formimi i Trupës Frymore, që njëherit rritë kompletimin e strukturës së FSK-së dhe forcon identitetin e saj.

Ky numër festiv i revistës ***"Forca Jonë"*** do të jetë numri i shtatë i edicionit mujor që botohet si shtojcë në gazetën Epoka e Re. Për shkak të shënimit të Ditës së Forcës dhe për nder të Festës së 28 nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar, që përkon më 100 vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, po e botojmë si revistë të ilustruar me moton - ***Me Forcën. Për Kosovën***.

Urime Festa e FSK-së - ***Dita e Forcës***, të gjithë ushtarëve, nënoficerëve oficerëve të FSK-së dhe stafit të MFSK-së.

Urime Ditën e Flamurit dhe 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë.

Botuesi: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun i MFSK-së.

MISIONI I MINISTRISË PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) është përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit civil mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), duke përfshirë këtu edhe menaxhimin dhe administrimin. MFSK, njëherësh, ka rolin e Shtabit të nivelit më të lartë të FSK-së.



Misioni i MFSK-së është të formulojë, të zbatojë, të vlerësojë dhe të zhvillojë politikat dhe aktivitetet e FSK-së, brenda kornizës ligjore dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

OBJEKTIVAT E FSK-SË PËR PERIUDHËN 2012-2013

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, që në fillim të marrjes së detyrës së ministrit ka shpalosur programin dhe obje-ktivat e tij për zhvillimin e FSK-së për vitin 2012-2013.

"Në fillim dëshiroj të theksoj se këtë vit qeveritar e filluam me objektiva të qarta, për zhvillimin e FSK-së. Kemi krijuar një vizion, e këtë vizion e kemi shndërruar në objektiva konkrete të cilat kemi arritur t'i plotësojmë me një angazhim vërtetë të gjith-anshëm, drejt realizimit të secilit objektiv veç e veç.

- Kemi arritur të plotësojmë rekomandimin për Kapacitetet e Plota Opera-cionale (KPO) nga komandanti i KFOR-it.
- Kemi krijuar një identitet të ri dhe unik kombëtar për FSK-në dhe gjeneratat e saja të reja.
- Kemi arritur të realizojmë Programin për Partneritet Shtetëror me Gardën Kombëtare të Ajovës.
- Kemi bërë hapat e parë në gjetjen e rrugës drejt NATO-s, nëpërmjet një raporti të partneritetit të përshtatur individualisht.
- Kemi organizuar takimin e parë në Kosovë të ministrave të Mbrojtjes të shteteve të rajonit dhe e kemi nënshkruar një Deklaratë të Përbashkët me të gjithë pjesëmarrësit, si dhe kemi marrë pjesë për herë të parë në një Iniciativë Rajonale siç është A5.
- Kemi hartuar Strategjinë e re të FSK-së, e cila është miratuar nga Qeveria.

"Të arriturat e këtij viti kanë krijuar një bazë të fortë për të gjithë ne, që së bashku t'i arrijmë këto objektiva me sukses".

MISIONI I FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është forcë e re, profesionale, shumetnike, e uniformuar dhe e armatosur lehtë, e sigurisë, e cila i nënshtrohet kontrollit demokratik-civil. Misioni i FSK-së është që të kryejë operacionet e reagimit ndaj krizave në Kosovë dhe jashtë saj;



operacionet e mbrojtjes civile brenda Kosovës; si dhe t'u ndihmojë autoriteteve civile në përgjigje ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave tjera.

Ministri i FSK-së: Ministria e FSK-së udhëhiqet nga ministri i FSK-së, i cili ka kontrollin e përgjithshëm dhe administrimin e MFSK-së dhe është anëtar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK). Ministri ka dy zëvendësministra dhe deri gjashtë këshilltarë politikë, të cilët mund të marrin detyra specifike të deleguara nga ministri. Përveç Kabinetit të Ministrit, Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Inspektoratit të FSK-së, të cilët janë të varur drejtpërdrejt nga ministri, për ministrin punojnë edhe departamentet e Ministrisë përmes sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë dhe komandantit të FSK-së.



Komandanti i FSK-së: Komandanti është në varësi të ministrit dhe ushtron komandimin e plotë të FSK-së dhe të komponentit rezervë. Komandanti i FSK-së është këshilltari kyç i Presidentit dhe Kryeministrit të Kosovës, në Këshillin e Sigurisë së Kosovës dhe i Ministrit të FSK-së për çështjet e lidhura për FSK-në, njëherësh është edhe anëtar i KSK-së.

Sekretari i Përgjithshëm: Sekretari është shërbyesi më i lartë civil në MFSK dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit të FSK-së. Ai duhet të jetë politikisht i paanshëm dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të Ministrisë, është përgjegjës për menaxhimin efikas të burimeve, duke përfshirë aktivitete ditore si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave afatgjate, planeve dhe programeve. Sekretari i Përgjithshëm, gjithashtu është përgjegjës për rekrutimin e personelit civil të Ministrisë si dhe bashkëpunon me Komandantin e FSK-së.

Drejtoria për Politikë dhe Plane - është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe planeve për MFSK-në dhe FSK-në. Pesë departamente punojnë drejtpërdrejtë nën Drejtorinë për Politikë dhe Plane: Departamenti i Personelit, Departamenti për Politikë

dhe Plane, Departamenti për Bashkëpunim në Çështje Sigurie, Departamenti për Menaxhim Financiar dhe Departamenti për Bashkëpunim Civil-Ushtarak (CIMIC).

Drejtoria për Operacione - është përgjegjëse për planifikimin dhe drejtimin e operacioneve të FSK-së, për logjistikë, komunikim dhe zhvillimin e doktrinave dhe koncepteve operative. Pesë departamente punojnë drejtpërdrejtë nën Drejtorin e Operacioneve: Departamenti për Inteligjencë dhe Siguri, Departamenti për Operacione dhe Trajnime, Departamenti për Logjistikë, Departamenti për Sistemin e Komunikimit dhe Informimit (SKI) dhe Departamenti për Çështje Mjekësore.

PROGRAMI SHTETËROR I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET AJOVËS DHE KOSOVËS



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK) Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjatë pjesëmarrjes në konferencën" Programi shtetëror i bashkëpunimit ndërmjet Ajovës dhe Kosovës", kanë prezantuar themelimin, zhvillimin dhe të ardhmen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri Çeku në paraqitjen e tij foli për aspektin politik të themelimit të FSK-së, zhvillimit të saj dhe objektivave të Ministrisë dhe Qeverisë për zhvillimin dhe modernizimin e strukturës së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri Agim Çeku me këtë rast përmendi edhe faktin se misioni i FSK-së është i përcaktuar me pakon e Ahtisarit dhe se më deklarimin e përmbushjes së kapaciteteve për FSK-në, janë krijuar mundësitë për më shumë kompetenca dhe hapjen e mundësive për integrime rajonale si edhe integrime në NATO.

KAPACITETET OPERACIONALE TË FSK-së

Arritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO) dhe shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve ekzistuese të FSK-së, janë garanci(siguri) për pronën dhe jetën e gjithë qytetarëve të Kosovës, si dhe për t'ju ofruar mbështetje institucioneve qendrore dhe lokale në përmbushjen e detyrave të tyre në fushën e sigurisë.



Disa nga arritjet më të theksuara janë:

- Kapacitetet e Plota Operacionale /KPO.
- Miratimi i Ligjit për Pensionet e FSK-së, hartimi i dokumenteve: doktrinave, koncepteve dhe procedurave standarde të FSK-së.
- Është bërë rekrutimi dhe përzgjedhja e rekrutëve, realizimi i disave nga ushtrimet fushore, si: ushtrimi fushor "Shpëtimtari 2011", ushtrimi "Luani i Shkathët1-4", pastaj ka pasur dhjetëra intervenime me sukses, të kërkim-shpëtimit, të zjarrfikjës, realizimin e 7 projekteve të xhenios, për ndërtimin dhe riparimin e rrugëve dhe infrastrukturës, operacionet e çminimit, intervenimet në 70 operacione të njësitit të MKAB-së etj.
- Ka diplomuar gjenerata 2012 e kadetëve të FSK-së, shkollimi i kadetëve në qendrat më të njohura ndërkombëtare, si në Turqi, Amerikë, Angli, Shqipëri, etj.

STRUKTURA E FSK-së

Komanda e Forcave Tokësore (KFT) - komandon dhe kontrollon, punëson, trajnon, pajis dhe mban njësitë e saja vartëse në Kosovë dhe jashtë saj. Atëherë, kur urdhërohet ofron forca të mbështesë misionin e saj në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera në Kosovë, përmes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Bashkërendon të gjitha kapacitetet, burimet dhe aktivitetet e Brigadës për Mbështetje Operacionale, të Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Brigada e Mbështetjes Operative (BMO) - ofron mbrojtje civile për qytetarët, logjistikën dhe kapacitetet e inxhinierisë, si dhe ofron shërbime mbështetëse për njësitë tjera të FSK-së. Ajo mund të formojë njësite që të reagojnë ndaj çdo krize dhe të ofrojë mbështetje për autoritetet civile në Kosovë, si dhe operacione të përbashkëta jashtë vendit.

Brigada e Reagimit të Shpejtë (BRSH) - gjeneron, trajnon, pajis, mban dhe komandon batalionet e saj vartëse si njësitë e reagimit ndaj krizave, si dhe mbështet dhe shton kapacitetet bazë të FSK-së.

Gjithashtu, ajo do t'u japë mbështetje autoriteteve civile në Kosovë, për operacione të përbashkëta jashtë vendit.

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes - është përgjegjëse të drejtojë trajnimin themelor, të specializuar, të udhëheqjes dhe kolektiv për personelin aktiv dhe rezervë të FSK-së. Në bashkëpunim dhe bashkërendim me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës zhvillon doktrinën, dokumentet dhe rregulloret themelore dhe përfundimtare, mirëmban Arkivin e Doktrinës dhe të botimeve.

INFRASTRUKTURA (KAZERMAT E FSK-së)

FSK-ja është e vendosur në 9 lokacione (kazerma) në tërë Kosovën. Shumica e këtyre kazermave, kanë pasur nevojë për rindërtim dhe meremetim. Po ashtu FSK-ja, ende, ka nevojë për ndërtimin e kazermave të reja. Disa projekte të meremetimit si dhe ndërtimi i objekteve të reja, janë të financuara nga Programi Donator i NATO-s dhe të zbatuara nga kontraktuesit vendorë. Të gjitha punimet e rëndësishme, do të jenë të kompletuara brenda vitit 2012. Ministria e FSK-së është duke bërë financimin e disa projekteve të infrastrukturës, të cilat do të rrisin kapacitetet e FSK-së për të kompletuar misionin e FSK-së. Kontribut të rëndësishëm kanë dhënë edhe ekipet këshilluese të NATO-s dhe KFOR-it. Integrimi në Strukturat Euro-Atlantike është njëri ndër objektivat

kryesorë të Kosovës, prandaj edhe të Ministrisë së FSK-së. Në mënyrë që të arrihet ky objektiv i rëndësishëm, ministria po bashkëpunon ngushtë me shtetet anëtare të NATO-s dhe të KFOR-it. Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi ndërkombëtar është që t'i mundësohet Kosovës dhe FSK-së që të marrin pjesë në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë.

Ndihma e NATO-s dhe e vendeve tjera partnere në të holla, trajnime dhe këshillime është shumë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e MFSK-së dhe FSK-së. Qëllimi i MFSK-së është që ta ngritë FSK-në në pajtim me standardet e NATO-s, prandaj ndihma dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm janë tejet të rëndësishme.



NDIHMA KËSHILLIMORE E NATO-s DHE KFOR-it

Si në ngritjen fillestare të MFSK-së dhe të FSK-së, ashtu edhe në zhvillimin e tyre të mëvonshëm, është dhënë një kontribut i rëndësishëm nga ekipet këshilluese të NATO-s dhe të KFOR-it.(Ekipi Këshillues i NATO-s/NAT dhe partneri i tyre nga KFOR-i, Divizioni për Bashkëpunim Civil-Ushtarak/MCAD). NAT-i e mbështet Ministrinë, në mënyrë që ajo të mund të ushtrojë kontroll dhe menaxhim efikas civil mbi FSK-në, të formulojë strategji dhe politika, ta zhvillojë një sistem të planifikimit, programimit, buxhetimit dhe ekzekutimit, të bëjë planifikim të forcës, të veprojë në ambiente ndërkombëtare si Forcë për paqe dhe siguri në rajon dhe të nënshkruajë marrëveshje të bashkëpunimit, të cilin mund ta ofrojë pastaj. MCAD-ja ndihmon në ngritjen e FSK-së brenda kompetencave të saj dhe ofron mentorim dhe trajnim të personelit të FSK-së dhe të njësive të saj.



TRAJNIMET DYPALËSHE NË KOSOVË DHE JASHTË SAJ

Në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i profesionalizmit brenda Ministrisë dhe FSK-së, MFSK-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë trajnimit të njerëzve si jashtë vendit, ashtu edhe duke ftuar ekipe trajnuese mobile në Kosovë. Prej themelimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë mbajtur rreth 90 kurse nga vendet partnere, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Shqipëria, Turqia, Holanda, Lituania dhe Japonia.

Realizimi i objektivit kryesor të FSK-së, arritja e kapaciteteve të plota operacionale dheplotësimi i standardeve të NATO-s kërkojnë stërvitje dhe trajnime cilësore, intensive dhe të vazhdueshme.

Objektivat e stërvitjes, që synohen të arrihen, ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në varësi të misionit, por teknikat e realizimit, të stërvitjes dhe të vlerësimit, do të zhvillohen me moton: stërvit, vlerëso dhe ri-stërvit, duke siguruar në të njëjtën kohë edhe vazhdimësinë e procesit në vetë-aftësim. Synimi i stërvitjes është që të formojë ushtarë dhe personel të motivuar, ushtarë dhe personel të disiplinuar dhe të aftë, të veprojë si individ, në përbërje të grupit, të njësisë, të kenë përgatitje të shkëlqyeshme psikofizike për të plotësuar kërkesat dhe cilësitë që e karakterizojnë pjesëtarin e FSK-së. Rezultatet e dëshiruara të stërvitjes arrihen përmes zbatimit të programeve institucionale, të organizuara në periudha dhe afate kohore, faza dhe module, në institucionet e stërvitjes, në njësi dhe nënnjësi. Sistemi i stërvitjes mbështetet në dy shtylla kryesore të zhvillimit. Stërvitja institucionale përfshin stërvitjen bazë dhe stërvitjen individuale të avancuar. Stërvitjet individuale, qoftë bazike, qofshin ato të avancuara, janë realizuar sipas kritereve dhe standardeve të NATO-s.

Stërvitja kolektive përfshin stërvitjen individuale përforcuese dhe stërvitjen kolektive të njësisë. Në këtë lloj stërvitje marrin pjesë të gjitha elementet përbërëse të një operacioni, të mbështetjes në operacion dhe elementet mbështetëse me shërbime të operacionit.

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

Në fillim të vitit 2009, që është edhe vit i themelimit të FSK-së, pas përzgjedhjes së parë të rekrutëve të FSK-së, trajnimet bazike kanë qenë të obliguara për të gjithë. Me themelimin dhe përgatitjen e Qendrës së Komandës – Doktrinës dhe Stërvitjes, që është e vendosur në kazermën e FSK-së në Ferizaj, për MFSK-në ishte edhe një hap i madh dhe i rëndësishëm në kompletimin e infrastrukturës. KDS, në bashkëpunim me Ekipin Trajnues të NATO-s, realizon program për stërvitje dhe shkollim profesional, shërbim të forcës profesionale, jo politike, shumetnike, për të përmbushur kriteret e stërvitjes dhe shkollimit sipas standardeve të NATO-s, si një forcë profesionale me shërbim vullnetar.

Në kuadër të KDS-së funksionojnë dy qendra: Qendra e Stërvitjes Bazike- Qendra e Stërvitjes Specialistike (QSS) dhe Qendra e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve (QZHPU). Në kuadër të ngritjes dhe profesionalizimit të KDS-së në mënyrë të vazhdueshme, një sukses i rëndësishëm dhe kyç ka qenë certifikimi i trajnerëve të FSK-së dhe kalimi i kompetencave për trajnim nga ndërkombëtarët tek trajnerët dhe instruktorët e FSK-së. Deri më tani në KDS, kanë përfunduar trajnimet bazike tri gjenerata të rekrutuara nga kontingjenti i popullatës civile.



Qendra për Studime Universitare (QSU) u themelua në qershor të vitit 2005. Qëllim parësor i kësaj qendre ishte edukimi dhe trajnimi i brezave të rinj, në fushën e udhëheqjes dhe shkencave ushtarake, në mënyrë që këta të rinj të jenë udhëheqës në të ardhmen. Gjithashtu, vlen të ceket ndihma e Universitetit Amerikan në Kosovë, Universitetit të Biznesit dhe Teknologjisë dhe Universitetit "Dardania", të cilët ofruan vende falas në vitin e parë për kadetët që të vijojnë studimet bachelor nëpër këto universitete.

Në gjeneratën e parë të kadetëve u pranuan 12 kadetë, me të cilët filloi trajnimi i oficerëve kadet. Sot, kjo qendër ka mbi 50 kadetë dhe 2 gjenerata të diplomuara. Në këtë vit në gjeneratën e gjashtë të kadetëve në QSU-së, janë pranuar edhe 10 studentë të rinj përmes konkursit publik, nga një numër i madh i konkurruesve.

Ky program është i bazuar në programin e edukimit dhe të trajnimit të oficerëve në SHBA. Është program katërvjeçar, ku çdo kadet është i obliguar të ndjekë një drejtim universitar në universitet civil, si dhe pjesën e shkencave ushtarake, të cilën kadetët e kryejnë në Qendrën për Studime Universitare.

Kadetët edukohen dhe trajnohen që të jenë: mendërisht vigjilent, fizikisht të fortë, moralisht të drejtë. Pra, i gjithë trajnimi është i dizajnuar, që kadeti t'i trajnojë kadetët e tjerë dhe të mësojë nga përvoja, në mënyrë që të jetë sa më i suksesshëm kur të dalë nëntoger. Shumica e kadetëve të gjeneratës së parë, që kanë diplomuar në QSU në vitin 2009, kanë vazhduar specializimin në lëmi të ndryshme ushtarake në SHBA dhe në Britani të Madhe.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR - RRUGË DREJT INTEGRIMEVE EURO-ATLANTIKE

Departamenti për Siguri dhe Bashkëpunim i FSK-së, objektiv kryesor e ka bashkëpunimin dhe integrimin në strukturat euro-atlantike. Që të arrihet ky objektiv i rëndësishëm, Departamenti për Siguri dhe Bashkëpunim ka arrit nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit me vendet partnere dhe ka hartuar planin dypalësh vjetor për bashkëpunim në fushën e sigurisë, me shtetet anëtare të NATO-s dhe të KFOR-it, me qëllimin kryesor që t'i mundësohet Kosovës dhe FSK-së që të marrin pjesë në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë. Ndihma e NATO-s dhe e vendeve tjera partnere, me trajnime dhe këshillime është shumë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e MFSK-së dhe të FSK-së, me standardet të NATO-s.

Departamenti për Siguri dhe Bashkëpunim ka për qëllim koordinimin dhe bashkëpunimin me shtetet e rajonit dhe më gjerë, si dhe arritjen e marrëveshjeve dhe memorandumeve me shtetet e rajonit dhe të botës. Plan dypalësh për vitin 2012, ministria ka nënshkruar me Maqedoninë, Shqipërinë, Turqinë, Gjermaninë, Danimarkën

dhe Holandën. Departamenti për Siguri dhe Bashkëpunim ka marrë pjesë në hartimin e rregullores për atashe ushtarak, pastaj hartimin e programit individual të partneritetit drejt integrimit në NATO, hartimin e planeve sinkronizuese me atashetë lidhur me realizimin e trajnimeve të arsimit dypalësh.

Ngjarja më kryesore është fuqizimi i partneritetit bilateral me SHBA-të, vendet e BE-së dhe vendet e rajonit dhe KFOR-in, e sidomos partneriteti me Gardën Kombëtare të Shtetit të Ajovës në SHBA, gjithashtu koordinimi i aktiviteteve për ushtrime dhe aktivitete e FSK-së, jashtë vendit, për Operacione Humanitare (bazuar në nevojat dhe planifikimet). Koordinimi është duke vazhduar përmes video-konferencave dhe përmes përfaqësuesve ushtarak të shtetit të Ajovës në Kosovë, përmes të cilëve bashkërendohen të gjitha aktivitetet e përbashkëta.

Me 14-16.08.2012 në Ajovë është realizuar konferenca "Gjithë Ajova për gjithë Kosovën" ku ka marrë pjesë një delegacion i gjerë i MFSK-së dhe FSK-së. Më datat 03-07.09.2012 ka qëndruar në një vizitë në Kosovë, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Timothy Orr. Po ashtu me datën 18-20.09.2012 një grup i oficerëve të Ajovës do të qëndrojë në FSK me qëllim të sinkronizimit të planifikimeve të përbashkëta për të ardhmen. Takime me atashetë e akreditуar në Kosovës janë realizuar në vazhdimësi çdo muaj. Është hartuar propozimi për atashe ushtarak, si në SHBA, Gjermani, Shqipëri, Bruksel, Turqi dhe shtete tjera.

Anëtarësimi në Kartën e Adriatikut dhe bashkëpunimi në kuadër të strukturave dhe iniciativave tjera rajonale. Pjesëmarrja e ministrit dhe zyrtarëve tjerë të lartë të MFSK-së, në Konferencën e Kartës së Adriatikut (A5) me datë 28-29.03.2012. Pjesëmarrje në konferencën e shefave të inteligjencës së Ballkanit Perëndimor me 17-20.04.2012. Pjesëmarrje në takimin e 27-të të Grupit Këshillues Shumëkombësh për Buxhetin më 18-19.04.2012. Pjesëmarrje në konferencën planifikuese të Qendrës Regjionale të Trajnimit për Komunikim në Maqedoni më 06-08.06.2012.

Pjesëmarrje në konferencën "Politikat e Përbashkëta të Mbrojtës - Kontributi i BE për Sigurinë dhe Përfshirja e Vendeve të EJL" në Maqedoni me 12-13.06.2012. Pjesëmarrje në konferencën e specifikimit të ushtrimit "Reagimi i Përbashkët 2013" në Shqipëri me 20.06.2012. Pjesëmarrja në konferencën "Mbështetja e Emergjencave - Zhvillimi i Kapaciteteve Rajonale" në Maqedoni me 29-30.06.2012. Pjesëmarrje në konferencën e 12-të të SEEC-së të forumit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së Ballkanit Perëndimor në Maqedoni me 02-04.07.2012. Pjesëmarrje në takimin vjetor të shefave të logjistikës (J/G4) të Forcave të Armatosura nën mbrojtjen e Kartës së Adriatikut në Mal të Zi me 10-12.07.2012. Pjesëmarrje në takimin e 7-të regjional të drejtorëve për Politika dhe Plane, zhvilluar në Ohër, Maqedoni me 31.10.2012



MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT

Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandën e Veriut më 29 maj 2009; Republikën e Lituanisë më 30 nëntor 2009; Mbretërinë e Holandës më 23 dhjetor 2009; Republikën e Turqisë më 24 dhjetor 2009; Republikën e Shqipërisë më 16 shkurt 2010; Republikën e Maqedonisë më 14 prill 2010; Republikën e Malit të Zi më 3 nëntor 2010; Republikën e Kroacisë 15 qershor 2012; Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mars 2011;Gardën Kombëtare të AJOVËS, 2011.

FSK-ja ka arrit partneritet shtetëror me Gardën Kombëtare të SHBA-ve, me shtetin Ajova. Në kuadër të këtij partneriteti janë realizuar: tri vizita nga gjeneralmajor Timothy Orr, nga Garda Kombëtare e SHBA, në MFSK; ministri dhe komandanti i FSK-së kanë vizituar Gardën Kombëtare të Ajovës; është realizuar vizita e një ekipi vlerësues nga Garda Kombëtare e Ajovës, gjatë ushtrimit fushor "Luani i Shkathët-4"; fillimi i procesit të integrimit të RKS-së në NATO dhe pjesëmarrja aktive në të gjitha veprimet, aktivitetet dhe projektet, të parapara në këtë proces, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në operacione paqeruajtëse dhe humanitare; është realizuar vizita e ministrit dhe komandantit të FSK-së në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s; vizita zyrtare e ministrit dhe komandantit të FSK-së, në Pentagon dhe në Departamentin e Shtetit Amerikan;emërimi i atasheut të parë të sigurisë së MFSK-së, në SHBA; ngritja e nivelit të bashkëpunimit dypalësh dhe përzgjedhja e 51 llojeve të trajnimeve në 11 shtete si me: Shqipërinë, SHBA-në, Britaninë e Madhe, Lituaninë, Turqinë, Estonin, Gjermaninë, Holandën, Japoninë, Sllovenine dhe Hungarinë.

OPERACIONET E NJËSIVE TË SPECIALIZUARA TË FSK-së



Njësitet e specializuara të FSK-së, të kërkim-shpëtimit, çminimit, MKABK-së etj, gjatë këtij viti kanë arrit rezultate të shkëlqyeshme, si brenda edhe jashtë Kosovës. Njëra ndër ngjarjet më të rëndësishme ka qenë zbarkimi i këtyre njësiteve në Poligonin Ushtarak në Krivollak të Maqedonisë, ku me sukses kanë zbarkuar jashtë shtetit, që shënon njërën nga ngjarjet më të rëndësishme të FSK-së, në këtë drejtim.

Intervenimi i njësiteve të kërkim-shpëtimit, në fshatin Restelicë të komunës së Dragashit, vitin e kaluar, dëshmoi se FSK-ja, ka arrit të plotësojë të gjitha kriteret e profesionalizmit të niveleve të Ushtrive të NATO-s. Ajo u shqua edhe me intervenimin e saj,(dy herë) në qytetin e Shkodrës, në Shqipëri, ku kanë ndihmuar qytetarët në përballimin e gjendjes së krijuar, pas përmbytjeve nga të reshurat e shiut.



FSK-ja NË INICIATIVAT RAJONALE

Ndërtimi i raporteve të partneritetit dhe të mirëbesimit me forcat e armatosura të të gjitha vendeve në rajon, si dhe anëtarësimi dhe pjesëmarrja e Kosovës në të gjitha iniciativat dhe projektet rajonale për mbrojtje dhe siguri, si p.sh., në Brigadën e Evropës Juglindore (SEEBRIG). MFSK-ja ka organizuar dhe realizuar Takimin e Parë të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të rajonit, në Republikën e Kosovës, ku edhe është bërë nënshkrimi i një Deklarate të përbashkët.

Për herë të parë, ministri dhe komandanti marrin pjesë në konferencën Karta e Adriatikut-A5, në Budvë, Mal të Zi, pjesëmarrja (për herë të dytë) në konferencën Karta e Adriatikut-A5, në Durrës, Shqipëri, pjesëmarrja për herë të parë në ushtrimin e përbashkët "Kampingu veror 2011", në Krivolak të Maqedonisë, në Marshin Tradicional, në Nijmegen të Holandës, pjesëmarrja në Ushtrime të Emergjencave në Slloveni (Njësiti i Kërkim-Shpëtimit), pjesëmarrja (Regjimenti i Mbrojtjes Civile/RMC) në trajnim për Teknikat e Nxjerrjes në Aksidente Trafiku, në Bullgari, nënshkrimi i Memorandumit për Bashkëpunim me Kryesinë e Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë, pastaj realizimi i takimeve dypalëshe me ministrat e mbrojtjes të vendeve të regjionit, në Republikën e Kosovës, me ministrin e Mbrojtjes së Maqedonisë etj .

Gjatë këtij viti janë realizuar këto vizita të rëndësishme: vizita e ministrit të Mbrojtjes së Gjermanisë, vizita e admiralit Samuel J. Locklear III, komandant i NATO-s, në Napoli, vizita e admiralit Montgomery, e admiralit Stavridis – NATO, është realizuar vizita e gjeneral Sir Peter Wall, shef i Shtabit të Përgjithshëm në Mbretërinë e Bashkuar etj.

FSK-ja ME NJËSI TË TASK-FORCËS SË KËRKIM-SHPËTIMIT

Formimi i Qendrës dhe të Njësisë së Task-Forcës, u bë me shkrirjen e dy njësive të Kërkim-Shpëtimit dhe të njësisë së Zjarrëfikjes. Qëllimi dhe objektivi kryesor i krijimit të Task-Forcës është shpëtimin e jetërës së qytetarëve. Njësia e Task Forcës do të jetë e trajnuar dhe e akreditуar ndërkombëtarisht e gatshme për zbarkim në regjion e kompletuar me trajnime dhe pajisje të një niveli të avancuar, me qëllim që të zhvilloj misione të spektrit të gjerë.

Pjesëtarët e Task-Forcës, do të trajnohen në bazë të standardeve më të larta, në mënyrë që Task-Forca të jetë e aftë të intervenojë në aksidente të rënda. Kjo është forcë e re në

rajon e cila do të ofrojë trajnime dhe intervenime, në rajon dhe më gjerë. FSK-ja ka bërë përzgjedhjen e 95 pjesëtarëve për Task-Forcën, të cilët kanë kaluar të gjitha testet kualifikuese. Qendra Regjionale e Task Forcës së FSK-së, po zhvillohet me përkrahjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës



FSK-ja REALIZON SHUMË PROJEKTE NË SHËRBIM TË QYTETARËVE

Departamenti i Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak (BCU) ka arrit realizimin e shumë projekteve të rendësishme që janë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës. BCU-ja perms nënshkrimti të marrëveshjeve të bashkëpunimit, me komunat: Malishevë, Rahovec, Gjilan, Kamenicë, Viti, Kllokot, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Suharekë, me qëllim të realizimit të Ushtrimit Fushorë "Shqiponja I" dhe për bashkëpunim në interes të qytetarëve.



Hartimi i Politikës së Bashkëpunimit Civil – Ushtarak në MFSK/FSK, Realizimi i Kampanjës të informimit për aplikim në Komponentin Rezervë në FSK.

Vazhdimi i ngritjes dhe ndërtimit të vlerave, të identitetit dhe vizibilitetit të FSK-së, Asistenca mjekësore në fshatrat: Dragolevc, Serbobran, Zallq dhe Gurakoc.

Ligjërata në shkollat e mesme dhe fillore të Kosovës të të gjitha komuniteteve , për vetëdijesim nga minat nga ana e FSK-së. Realizimi is humë projekteve në shërbim të qytetarëve, si: Renovimi e Qendrës së Kujdesit të Nënës dhe Fëmijës në Prishtinë, reaizyuar në bashkëpunim me Zyrën për Bashkëpunim të Ambasadës së SHBA-ve, Rregullimi dhe rrafshimi i rrugës në fshatin: Zallq Komuna e Istogut të gjatë mbi 1.5 km, rregullimin e rrugës, 5km, në bashkëpunim me ICITAP-in, në fshatin Turiqicë, komuna e Podujevës, rregullimi i ambientit për varrezat e luftës, në fshatin Dyz, Komuna e Podujevës, Rrafshimi dhe ngjeshja e zhavorrit në oborrin e shkollës fillore "Gjergj Fishta", fshatin Jagodë, Komuna e Klinës, realizuar në bashkëpunim me KFOR-in, rregullimin e rrugës në Leskoc, Komuna e Klinës, hapjen e kanalit për ujëra të zeza çerdhes së fëmijëve e realizuar në bashkëpunim me Organizatën "Critas Umbria", pastaj në bashkëpunim me Institucionet vendore dhe Ndërkombëtare është realizuar projekti i gërmimin në Zhilivodë, Komuna e Vushtrrisë, FSK ka mbështetur me makineri dhe personel.

Projekti më i madh është ai i Junikut, hapja dhe zgjerim i rrugës të gjatë mbi 14 km, ku i lidh shumë fshatra. Një ngjarje shumë më rendësi është edhe dhurimi vullnetar i gjakut, Pastrimi dhe nivelizimi i terenit në Lubizhdë të Prizren, pastrami i objektit të vjetër, rënuar, shkollorë në fshatin Nekovc të Komunës së Drenasit, etj, pastaj ka organizuar mbjelljen e fidaneve në Mitrovicë dhe KFT në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ambientit, organizimin për bartyjen e personave me aftësi të kufizuara (Distrofi Muskolare) në Kalanë e Prizrenit, etj.



DEMINERËT KANË PASTRUAR MBI SHTATËQINDMIJË METRA KATRORË SIPËRFAQE TË MINUARA

Pastrimi dhe shkatërrimi i minave dhe i mjeteve shpërthyese është një nga objektivat bazë të FSK-së, me qëllim të mundësimit të lëvizjes së sigurt të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Pavarësisht se organizatat lokale dhe ato ndërkombëtare, kanë kryer aktivitetet e çminimit, gjatë periudhës së pasluftës, ka ende fusha që nuk janë pastruar dhe janë shumë të rrezikshme për jetën e qytetarëve të Kosovës. Kompania e Deminimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile e FSK-së, e trajnuar mirë profesionalisht dhe e pajisur me mjete teknike, vazhdon aktivitetin e çminimit humanitar dhe eliminimin e mjeteve eksplozive.

Për këtë qëllim, ekziston Qendra Koordinuese për Deminim dhe EOD në kuadër të MFSK-së. EME është përgjegjëse të mbikëqyrë dhe koordinojë të gjithë pastrimin nga minat dhe mjetet e pashpërthyera në Kosovë, duke përfshirë sigurimin e kualitetit dhe edukimin për rrezikun nga minat. Qendra Koordinuese për Deminim përbëhet nga 4 ekipe (secili ekip ka 25 pjesëtarë). Të gjitha ekipet janë të trajnuara për çminim humanitar dhe pastrim të fushëbetejave, si dhe një tog është i trajnuar për detyra dhe përgjegjësi të EME-së.

Tri togjet e Kompanisë së Deminimit operacionet e çminimit i kanë kryer në këto vendbanime: Ferizaj, Belince, Hajvali, Koshare, Doberqan, dhe Harilaq. Çminuesit e FSK-së gjatë operacioneve të çminimit kanë pastruar 701669 metra katror dhe kanë gjetur 2085 mjete te ndryshme eksplozive të pashpërthyera.

Kompania e Deminimit e FSK-së ka filluar zhvillimin e operacioneve të EOD-së sipas procedurave të përbashkëta të veprimit të miratuara nga KFOR dhe MFSK, që nga data 30 gusht 2010, ku kanë filluar të mbajnë edhe kujdestarinë njëzetekatërorëshe me dy ekipe; njëra në Prizren dhe tjetra në Pomozotin. Që nga fillimi i këtyre operacioneve njësitet kujdestare të EOD-së kanë intervenuar në 661 raste duke shkatërruar 1260 mjete të ndryshme eksplozive, kurse vetëm gjatë vitit 2012 deri më tani kanë intervenuar në 337 raste ku kanë shkatërruar 402 mjete të ndryshme eksplozive. Gjatë periudhës dimërore nuk ka aktivitete të çminimit përveç ekipeve kujdestare për intervenime. Kompania e Deminimit përveç trajnimeve rifreskuese po ashtu zhvillon aktivitetet për edukimin e rrezikut nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera në shkolla të ndryshme të Kosovës.



RISHIKIMI STRATEGJIK I SEKTORIT TË SIGURISË

Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës dhe Rekomandimeve të Këshillit të Sigurisë, rishikimi i legjislacionit ekzistues dhe hartimi i legjislacionit të ri, krijimi i strategjisë dhe doktrinave, strukturave organizative, si dhe përcaktimi i misionit dhe detyrave kushtetuese, për ta ngritur FSK-në në një forcë me të gjitha kapacitetet e nevojshme, për mbrojtjen dhe sigurinë e vendit tonë dhe qytetarëve të saj. E arritur tjetër është krijimi i Strategjisë së FSK-së dhe miratimin e saj në Qeveri, pastaj krijimin dhe propozimin për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë, kemi lobuar për mbështetje të vizionit të FSK-së, për të ardhmen. Aprovimi i Kapaciteteve të Plota Operacionale nga ana e Këshillit Veri-Atlantik të NATO-s, si dhe shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve në kryerjen e misionit kushtetues dhe në ndihmë autoriteteve civile dhe komuniteteve.

Zbatimi i operacioneve të çminimit, kërkim-shpëtimit, zjarrfikjës, shkatërrimi i mjeteve të pashpërthyera (EOD), materiet kimike-atomike-biologjike (MKAB)etj, projekte humanitare, trajnime në vend dhe jashtë vendit, ngritja e komponentit rezervë dhe korit të nënoficerëve, marrja e detyrave shtesë në përkrahje të KFOR-it dhe autoriteteve civile, vazhdimi i kontratave dhe zbatimi i Ligjit për Pensione, vazhdimi i ngritjes dhe ndërtimit të vlerave, të identitetit dhe fizibilitetit të FSK-së, uniformat unike të FSK-së, gazeta mujore e FSK-së, emisioni televiziv i FSK-së, Muzeu i Forcës, Shtëpia e Forcës, manifestimi tradicional në Divjakë, më 10 Qershor, shënimi i Ditës së Rezistencës më 5 Mars, shënimi i Ditës së Forcës, më 27 Nëntor, fuqizimi i partneritetit dypalësh me SHBA-të, vendet e BE-së, vendet e rajonit dhe KFOR-in.

Pastaj, implementimi i Programit të Partneriteti Shtetëror me Gardën Kombëtare të Ajovës, SHBA, emërimi i atasheve ushtarakë në së paku në katër ambasada, nënshkrimi i MOU-ve dhe SOFA-ve me vendet me të cilat ende nuk janë nënshkruar, vizita të ndërsjella të ministrave/delegacioneve të ndryshme, trajnime të liderëve, oficerëve, nënoficerëve dhe njësive, implementimi i planit të avancuar të bashkëpunimit me KFOR-in, anëtarësimi në Kartën e Adriatikut dhe bashkëpunimi në kuadër të strukturave dhe iniciativave tjera rajonale të sigurisë, pjesëmarrja në ushtrimet fushore rajonale, pjesëmarrja në kampin veror në Krivolak, Maqedoni, pjesëmarrja në marshimin tradicional në Holandë, pjesëmarrja në pelegrinazhin ushtarak në Lourdes, Francë, vendosja e raporteve formale të partneritetit me NATO-n dhe pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse dhe humanitare, implementimi i procesit të vetëvlerësimit të integritetit profesional të FSK-së, hartimi i programit individual të partneritetit dhe bashkëpunimit me NATO-n, trajnime familjarizuese me NATO-n, trajnime për misione paqeruajtëse, shkuarja në operacione paqeruajtëse dhe humanitare, rishikimi i strukturës, misionit dhe detyrave të MFSK/FSK-së, në kuadër të RSSS-së, rishikimi funksional i strukturës aktuale me miratimin e Qeverisë, rishikimi i kufizimeve kushtetuese dhe ligjore të FSK-së, projekt-propozimi për evoluimin e MFSK/FSK-së.

RRITET INTERESIMI I PJESËTARËVE TË KOMUNITETEVE PËR FSK-në

Zyra për Çështje të Komuniteteve ka mision parësor përcjelljen e të gjitha çështjeve, që kanë të bëjnë me pjesëtarët e FSK-së dhe të MFSK-së, që vijnë nga radhët e komuniteteve. Kjo zyrë ndjek dhe promovon barazinë e të gjithë pjesëtarëve të MFSK-së/FSK-së, pa marrë parasysh origjinën etnike të tyre, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet në fuqi. Detyrë e Zyrës për Komunitete është që të kontribuojë në zbatimin e ligjeve dhe



rregulloreve të MFSK-së që të promovojnë një standard të lartë, të respektimit të të drejtave të të gjithë pjesëtarëve, nga radhët e komuniteteve pakicë. Afirmimi i të drejtave të minoriteteve në kuadër të MFSK-së është bazë e mirë për suksesin individual dhe atë kolektiv të njësive të MFSK-së. Përmes kësaj zyre është bërë përzgjedhja e kadetëve për shkollim në kuadër të Akademisë Ushtarake në Maqedoni. Zyra për Komunitete në MFSK ka arrit që të ketë një bashkëpunim të ndërsjellë në rajon, si me Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë, me KFOR-in, NAT-in, BCU-në etj. Në bashkëpunim me BCU-në ka organizuar vizita dhe ligjërime për vetëdijesimin e nxënësve minoritarë për mina dhe mjetet të tjera të pashpërthyera, pjesëmarrjen në seminarin e organizuar nga KFOR-i, pastaj monitorimin e organizimit të ndihmave mjekësore të banorëve serbë në fshatrat: Dragolev, Zallq, Serboban etj.Me KFOR-in, NATO-n dhe BCU-në ka organizuar seminarin për "Integrimin dhe Perspektivën Gjinore" si dhe ka zhvilluar një bashkëpunim të gjerë, me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, pastaj ka mbajtur seminarin në Ministrinë e FSK-së, me titull,"Komunitetet në Forcën e Sigurisë të Kosovës."Zyra dallohet edhe për bashkëpunim me ICO-në, (Integrimi i Komuniteteve), ICITAP-programi për edukimin e të rinjve, bashkëpunimi me komunat për komunitete, me OSBE-në dhe me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete.Si rezultat i punës me komunitete është edhe fushata e rekrutimit, e cila ka ndikuar që në mënyrë të konsiderueshme të rritet numri i minoritarëve në FSK. Kjo rritje ka reflektuar edhe në rritjen e përqindjes së përfaqësimit të komuniteteve pakicë në MFSK .

SHKALLË E LARTË E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË MFSK

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) krahas ngritjes së kapaciteteve të plota operacionale, rëndësi të veçantë i kushton respektimit dhe avancimit të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, gjë që është dëshmuar në mënyrë të përhershme që nga themelimi i kësaj force. MFSK ka krijuar infrastrukturë ligjore, e cila garanton pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialin e tyre individual në zhvillimin e FSK-së, si dhe përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.

Njësia për të Drejtat e Njeriut në vazhdimësi punon për përfaqësimin e duhur të komuniteteve dhe femrave. Tanimë, NJDNJ ka nxjerr Politikën për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, dokument ky që përcillet edhe nga Planin i Veprimit, i cili parasheh hapat konkret për zbatimin e kësaj Politike.

Deri më tani MFSK dhe FSK ka organizuar seminare në nivel rajonal dhe ndërkombëtar si dhe trajnime, punëtori të veçanta për vetëdijesim të femrave për përfshirjen e tyre në FSK. Inkurajimi i fermave për tu bërë pjesë e FSK-së është bërë edhe gjatë fushatave rekrutuese, përmes ekipeve mobile dhe statike, medieve dhe takimeve me qytetarë

nëpër komuna etj. Aktualisht në MFSK përqindja e femrave është 32%. Ndërsa, përqindja e femrave të uniformuara në MFSK/FSK është 8.23%, përkatësisht 188 femra në uniformë në gradën e oficerit dhe nënoficerit. Në gradën e kolonelit kemi një femër, përkatësisht zëvendëskomandant në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.

Në gradën e nënkolonelit kemi një femër në pozitën e Komandantit të Kompanisë së Mjekësisë.

Në gradën e majorit kemi 4 femra

Në gradën e kapitenit kemi 4 femra

Në gradën e togerit 5 femra

Në gradën e nëntogerit 4 femra

Njësia për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me Zyrën për Komunitete në MFSK dhe zyrtaren për Barazi Gjinore në KFT kanë mbajtur një cikël të punëtorive nëpër njësi dhe batalione të FSK-së me qëllim që të arrihet standardi për respektimin e të drejtave të njeriut në institucionin e MFSK-së dhe FSK-së. NJDNJ ka monitoruar procesin e rekrutimit për pranimin e kadetëve për shkollim në Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së, për vitin akademik 2012 / 2013 gjenerata e 8.Njësia për të Drejtat e Njeriut ka marrë pjesë (në cilësi të vëzhguesit) në Komisione përzgjedhëse në MFSK dhe FSK.

Njësia për të Drejtat e Njeriut në MFSK ka përgatitur një analizë lidhur me plotësimin e kuotave ligjore sa i përket përfaqësimit të fermave dhe komuniteteve në MFSK dhe FSK, si dhe një analizë lidhur me gjendjen e komuniteteve në MFSK dhe FSK. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional kemi zhvilluar një sërë takimesh si me : Avokatin e Popullit , NAT, PK, OJQ, KFOR, ZQM. Koordinatorët e NJDNJ-ve. Qëllimi i takimeve ishte bashkëpunimi ndërinstitucional dhe informues që ka të bëjë me të drejtat e njeriut. Pjesëmarrja në seminare, konferenca dhe trajnime të ndryshme.

UNIFORMA E RE E FSK-së



Forca e Sigurisë e Kosovës i ka krijuar emblemat dhe uniformat e reja. Këto janë zgjedhur dhe dizajnuar ekskluzivisht për Forcën e Sigurisë të Kosovës, nga ekspertë ushtarakë vendorë dhe ndërkombëtarë, më 2012.

Emblemat dhe gradat barten në uniformat e reja të kamufluara dhe kanë ngjyrën e gjelbër, ngjyrë kjo e veçantë i cila i shkon traditës së Kosovës. Ligji për Forcën e Sigurisë të Kosovës, bazuar në nenin 15, përcakton 9grada për oficerët e FSK-së dhe 6 grada të tjera për nënoficerë.

Gradat e oficerëve janë këto: gjenerallejtënant, gjeneralmajor, gjeneral brigade, kolonel, nënkolonel, major, kapiten, toger, nëntoger, rreshter i parë, rreshter major, kapter, rreshter, tetar dhe ushtar. FSK-ja, si forcë e uniformuar dhe profesionale, vlerësohet edhe për mënyrën se si pjesëtarët e saj e bartin uniformën dhe gradat. Një pamje korrekte me uniforma dhe grada të rregullta kërkohet nga të gjithë pjesëtarët e FSK-së. Kjo kontribuon në ndërtimin e një force efektive e të dinjitetshme.



FORCA JONË

* * * Viti I • Nr. 8 • Nëntor 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Mbahet konferenca rajonale tre palësh:Kosovë-Shqipëri-Maqedoni

Marrëveshje për Përballimin e Situatave të Emergjencave Civile

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 11 dhjetor 2012, ka organizua konferencën rajonale me temë: "Ndërtimi i kapaciteteve rajonale për menaxhimin e krizave". Qëllimi kryesor i konferencës ishte modernizimi i aftësive të menaxhimit të krizave dhe bashkëpunimi rajonal midis Republikës së Shqipërisë, të Kosovës dhe Maqedonisë.

Punimet e konferencës e hapi ministri i FSK-së Agim Çeku, ndërsa në emër të Qeverisë së Kosovës i përshëndeti zëvendëskryeministri i Kosovës Hajredin Kuçi, i cili shprehu mirënjohjen për këtë konferencë, duke e cilësuar të rëndësishëm



bashkëpunimin rajonal dhe shmangien e krizave. "Qeveria e Kosovës do t'i marrë seriozisht të gjitha rekomandimet që dalin nga kjo konferencë dhe se ky bashkëpunim do të shërbej si shembull i mirë në procesin e integrimeve euroatlantike".

Zv.ambasadorja amerikane në Kosovë, znj. Kelly Degnan, theksoi faktin se, ambasada amerikane inkurajon një nismë të tillë dhe se duhet të jemi të përgatitur për të ndihmuar njerëzit në rast emergjencash."Kjo konferencë është hapi i parë drejt zhvillimit të qasjes regjionale për t'u përgatitë dhe për të qenë në gjendje që të përgjigjeni së bashku me sektorin e sigurisë në zhvillim të kapaciteteve emergjente". Majori Brian Kreitlow, nga EUCOM-i, e cilësoi si hapin e parë, pas kësaj konference, është zhvillimi i kapaciteteve ndërkombëtare. "Ne e përkrahim përgjigjen ndaj krizave, por do të dëshironim që të keni kapacitete të ndërtuara regjionale. Duhet të shikohet fushëveprimi në mënyrë që të përfshihen të gjitha shtetet regjionale si Bosnja dhe Mali i Zi, në baza të rregullta veprimi".

Ne, në këtë konferencë i ftuam të gjitha vendet e rajonit që t'i bashkohen kësaj iniciative tha ministri Agim Çeku, me synim të qartë që të arrihet një marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë në rast emergjencash. Qëllimi i kësaj qasjeje rajonale është inkorporimi i konceptit "Mbrojtja e zgjuar civile", parim themelor i të cilit është, me investime më të vogla të fitohet më shumë. Kjo nënkupton shmangjen e dyfishimeve të forcave dhe burimeve (resurseve) në rajon me krijimin e qendrave rajonale. Ministri }eku shtoi se një ndër objektivat e Kosovës në përgjithësi dhe të FSK-së në veçanti, është bashkëpunimi rajonal në të gjitha fushat. "Sot jemi mbledhur përfaqësues të Ministrive të Punëve të Brendshme dhe Ministrive të Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, për të iniciuar një projekt rajonal për ndihmë në menaxhimin e emergjencave. Në kushtet aktuale ekonomike kur çdo vend ka prioritetet më të larta, asnjë vend vetëm nuk mund t'i përballoj dhe t'i zhvilloj të gjitha kapacitetet, aftësitë si dhe forcat e nevojshme për situatat emergjente. Por është e nevojshme që me një marrëveshje të zhvillohen ato kapacitete të cilat mund t'i jepen në dispozicion edhe vendeve tjera. I tërë ky projekt është duke u zhvilluar me përkrahjen dhe ndihmën e Komandës së Ushtrisë Amerikane në Evropë, duke u nisur nga shembulli i marrëveshjes që kanë gardat kombëtare të shteteve të ndryshme në mes veti, brenda SHBA-ve. Si pjesë e këtij projekti ne me mbështetjen e SHBA-ve jemi duke ndërtuar njësitin rajonal të ekselencës, i cili do ta ketë njësitin rajonal të kërkim-shpëtimit dhe qendrën rajonale të trajnimit për kërkim-shpëtim. Me këtë rast ministri Çeku falënderoi ndihmën e pakursyer që po japin SHBA-të në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së dhe bashkëpunimin e ngushtë me Gardën Kombëtare të Ajovës. Kuptohet se reaguesit e parë në ballafaqimin me situatat e jashtëzakonshme janë agjencitë për menaxhimin e emergjencave, dhe vetëm në rast pamundësie të menaxhimit të situatave kërkohet ndihma e ushtrive. Dhe kjo është arsyeja e prezencës së ministrave të Mbrojtjes, për të dëshmuar gatishmërinë për asistencë ushtarake.

Konferenca i përmbylli punimet me nënshkrimin e marrëveshjes rajonale, për "Përballimin e Situatave të Emergjencës Civile", të nënshkruar nga ministrat e mbrojtjes dhe ministrat e punëve të brendshme, si dhe drejtorët e qendrave të menaxhimit të krizave.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, në konferencën për media, ministri Çeku deklaroi se FSK-ja është e gatshme të kontribuojë në regjion, ndërsa theksoi se në rastet e katastrofave natyrore mirëpret ndihmën dhe bashkëpunimin e vendeve të rajonit.

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Arben Imami përshëndeti Komandën Amerikane për Evropë, për mbështetjen që po jep në këtë drejtim. Ky është një akt shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit konkret, është një shembull shumë i mirë edhe për vende të tjera të rajonit, përfshirë Malin e Zi, Bosnjën, Kroacinë, pse jo edhe Serbinë, në kuadër të A5, për bashkëpunimi rajonal. Në fund ministri Imami tha se më e rëndësishme është se ne, sot, tri vendet tona, vendosëm që të marrim një hap konkret përpara, i cili në radhë të parë do t'iu vlejë qytetarëve në raste të krizave dhe fatkeqësive natyrore.

Ndërsa, ministri i Mbrojtjes i Maqedonisë, Fatmir Besimi tha: "Kjo konferencë është më rëndësi sepse bashkëpunimi i deritashëm në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, sot po merr edhe një vlerë shtesë, gjegjësisht iniciativa për një qasje të përbashkët në kuadër të emergjencave natyrore. Atë çka mund të bëjmë ne është se mund t'i menaxhojmë veprimet tona, me qëllim që t'i minimizojmë humbjet, dëmet dhe në këtë drejtim bashkëpunimi tani më nuk është në pyetje. Modelet që këtu u prezantuan janë më të provuara në botë, si shembulli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe jo rastësisht vije përkrahja e Komandës së SHBA-së, si partner strategjik për të gjitha vendet e rajonit.

Konferenca "Ndërtim i kapaciteteve rajonale për menaxhim të krizave" u mbajt në kuadër të bashkëpunimit trepalësh në fushën e menaxhimit të krizave dhe emergjencave të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës.



Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë ta formojnë Ushtrinë e Kosovës

Portali ushtarak amerikan "Stars and Stripes" shkruan se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë të formojnë Ushtrinë e Kosovës, e cila në një afat sa më të shkurtër do t'i bashkohej trupave ushtarake të NATO-s. Gati pesë vjet qysh kur Kosova shpalli pavarësinë, lojtarët e mëdhenj në skenën ndërkombëtare e inkurajojnë Kosovën të lëvizë dhe vetëm të bëjë hapa. Njëri nga hapat e parë, siç thotë portali, është krijimi i një ushtrie nga aktualisht 2.500 pjesëtarë, të cilët tani për tani e përbëjnë Forcën e Sigurisë së Kosovës. Kjo është një detyrë e vështirë për kombin e ri që ende nuk e ka siguruar njohjen e plotë ndërkombëtare dhe që gjithnjë kërcënohet nga fqinji i saj verior Serbia, nga e cila shpalli pavarësinë në vitin 2008", shkruan në portalin ushtarak, "Stars and Stripes. Edhe ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku ka deklaruar se në vitin 2013 Kosova do ta ketë ushtrinë e vet, e cila do t'i bashkohet trupave të NATO-s ku bën pjesë edhe Shqipëria.

Qytetarët e Kosovës më së shumti i besojnë Forcës së Sigurisë së Kosovës

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka publikuar rezultatet paraprake të sondazhit "Barometri kosovar i sigurisë", në vlerësimin e sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe politikës së jashtme. Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës ka dalë të jetë më e besueshmja. Qytetarët e Kosovës, sipas këtij publikimi më së shumti janë shprehur të kënaqur me punën e Forcës së Sigurisë së Kosovës më 72 % , e përcjellë nga KFOR-i më 60% , policia e Kosovës 42% etj.



Drejtori i kësaj qendre, Florin Qehaja, ka thënë se programi "Barometri kosovar i sigurisë" ka për qëllim të bëjë matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me institucionet e sigurisë. Përmes këtij hulumtimi, ne, po iu kontribuojmë proceseve të rëndësishme në vend, ngase konsiderojnë që tashmë ka ardhur koha që fjala e qytetarëve të mbizotërojë në raport me vendimet që merren në nivel qeveritar dhe në nivele të larta ndërkombëtare.

Sipas, Armend Mujës nga kjo qendër, publikimi është bazuar në hulumtimin e opinionit publik sipas një sondazhi me anketa."Është matur kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet e sigurisë. Institucioni i sigurisë i cili gëzon kënaqshmërinë më të madhe te popullata është Forca e Sigurisë së Kosovës, ajo pasohet nga KFOR-i. Sipas kësaj ankete, qytetarët e Kosovës më së shumti i besojnë Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Letër urimi i komandantit për pjesëtarët e FSK-së

Kam kënaqësinë e veçantë që në këtë fundvit, në emër të FSK-së dhe në emrin tim, t'ju uroj gjithë pjesëtarëve të FSK-së festat e fundvitit. FSK-ja në këtë fundvit, padyshim se mund të krenohet me të arriturat e saj në të gjitha fushat. Me përkushtimin dhe angazhimin e saj maksimal ka mbajtur lartë motivin dhe ka krijuar një ambient të sigurt për qytetarët e Republikës së Kosovës. FSK-ja ka rritur aftësitë për zbarkim jashtë vendit dhe është angazhuar në nismat rajonale, duke treguar se është një forcë profesionale, shumetnike, në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj dhe në të mirën e paqes në rajon.

FSK-ja edhe gjatë këtij viti më shumë se kurdoherë ka mirëmbajtur dhe ngritur më tej kapacitetet operuese të saj. Zhvillimi i operacioneve çminuese, operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe atyre humanitare, këtë vit vazhdoi me një ritëm dhe intensitet edhe më të shtuar. Ky vit, ishte vit i rritjes së standardeve tona operuese. FSK-ja ishte edhe më afër qytetarëve, duke iu përgjigjur çdo kërkese për të intervenuar anekënd vendit, në largimin e mjeteve shpërthyese, kërkimin dhe shpëtimin e banorëve të kërcënuar nga fatkeqësitë e ndryshme. Pjesëtarët e FSK-së këtë vit kanë pastruar me mijëra metra katror nga mjetet e pashpërthyera, duke krijuar një mjedis më të sigurt. Pjesëtarët e FSK-së kanë qenë afër qytetarëve, institucioneve dhe shoqërisë civile, duke i mbështetur në projekte humanitare. Kontributi i FSK-së në rritjen e mirëqenies se qytetareve tanë, si ndërtimi i shtëpive, ndihma mjekësore për pjesëtarët e komuniteteve pakicë, ndërtimi i rrugëve, urave, largimi i materieve të rrezikshme, vetëdijesimi i qytetareve për rreziqet nga mjetet shpërthyese, janë shembujt më të mirë të gatishmërisë sonë për të qenë kurdo dhe kudo në shërbim të qytetarëve.

Ne mund të krenohemi edhe me disiplinën e pjesëtarëve tanë, të cilët kanë treguar motiv të lartë, profesionalizëm dhe integritet, duke qenë të përkushtuar në punë dhe stërvitje. Stërvitja e pjesëtarëve ishte objektiv dhe prioritet gjatë këtij viti. Gatishmëria e tyre për t'u sfiduar në stërvitjet më komplekse dhe për të rritur aftësitë e tyre profesionale, janë për t'u admiruar. Stërvitjet e organizuara dhe të zhvilluara me standardet e përafërta me ato të ushtrive të NATO-s, partnerëve tanë që veprojnë në kuadër të KFOR-it dhe vendeve të NATO-s, të kryera në KDS, qofshin ato individuale, të udhëheqësve (liderëve) dhe ato kolektive, të kryera dhe nëpër njësi, si dhe ato jashtë vendit, të mbështetura nga KFOR-i, SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Turqia dhe vendet tjera mike, kanë rritur aftësitë operuese të njësive tona, për çka dua të shpreh falënderimin tim të sinqertë për të gjitha vendet kontribuuese. Ky fundvit na gjen më të stërvitur, më të përkushtuar dhe më të fortë. Na gjen me identitet të përvijuar qartë. Tashmë pjesëtarët tanë identifikohen me shenja dhe uniforma unike. Njësitë tona janë më të kompletuara me pajisje, infrastrukturë dhe me burime, të cilat kanë rritë operueshmërinë dhe kanë bërë që njësitet tona të jenë të gatshme, më të efektshme dhe më afër plotësimit të standardeve të NATO-së. Një e arritur që duhet theksuar është padyshim procesi i standardizimit të dokumentacioneve, pajisjeve dhe mjeteve.



FSK-ja padyshim se mund të krenohet edhe me rritjen e aftësive zbarkuese. Njësitë tona këtë vit zbarkuan disa herë jashtë vendit, për të zhvilluar stërvitje për mbajtjen nën kontroll komunikimin në mes njësive. FSK-ja po shfaqet si një forcë kontribuuese e sigurisë në rajon, dhe e cila po merr pjesë në të gjitha nismat, qoftë në nivel rajonal ose edhe më gjerë. Objektivi ynë për t'u rreshtuar krahë për krah vendeve anëtare të NATO-s, vendeve aspirantë dhe partnerëve, duke marrë pjesë në ushtrime të përbashkëta, me qëllim të rritjes se bashkëpunimit në sigurinë rajonale, u provua si kurrë më parë. Këtë vit ishim bashkë me partnerët tanë në konferenca të rëndësishme, si atë të shefave të mbrojtjes të vendeve të A5, konferencat planëzuese të ushtrimeve të përbashkëta etj. Ne po punojmë dhe jemi të gatshëm të bashkëpunojmë për të kontribuar në sigurinë rajonale, duke ngritur njësitin zbarkues të kërkim-shpëtimit dhe ngritjen e një qendre të ekselencës për stërvitje jo vetëm të pjesëtarëve tanë, por edhe të vendeve të rajonit. Për këtë falënderojë veçanërisht SHBA-të, të cilat po japin një kontribut të madh në ngritjen, stërvitjen dhe pajisjen e këtij njësiti.

Ky vit për neve ishte vit i sfidave dhe i përkushtimit, në realizimin sa më kualitativ të misionit dhe objektivave tona. FSK-ja qysh në nëntor të vitit të kaluar i ka përmbushur kapacitetet operacionale dhe për këtë komandanti i KFOR-it e ka dhënë rekomandimin e tij. Ne nuk jemi ndalur me kaq, gjatë këtij viti kemi rishikuar kapacitete tona operacionale, kriter për kriter, duke e vlerësuar progresin e arritur përmes Raportit Përfundimtar të Progresit, me çka kemi konstatuar një ngritje cilësore në shumë fusha, ku kishim evidentuar mangësi. Kjo e përforcon edhe njëherë gatishmërinë tonë për të marrë përgjegjësi të reja. FSK-ja ka treguar gatishmëri, për të dhënë kontributin e saj në Rishikimin e Sektorit të Sigurisë dhe arkitekturës së re të sigurisë së Kosovës. Shumë ekspertë të FSK-së janë angazhuar nëpër grupe të ndryshme punuese, duke i dhënë cilësi këtij procesi. FSK-ja ka arritur të fillojë procesin e pensionimit të pjesëtarëve të saj, një arritje kjo që ndikon në freskimin dhe plotësimin me kuadro të reja të FSK-së. FSK-ja vazhdon të mbetet e përkushtuar në ruajtjen dhe rritjen e përqindjes së pjesëtarëve të komuniteteve pakicë e veçanërisht të pjesëtarëve të komunitetit serb, duke siguruar kushte të barabarta, si dhe duke organizuar fushata rekrutuese nëpër vendbanimet e tyre.

Sukseset e arritura na bëjnë të krenohemi, na japin besim edhe më të madh në aftësitë tona. Sukseset tona janë fryt i mundit, djersës dhe dijës së të gjithë pjesëtarëve tanë, që me përkushtim dhe profesionalizëm, po iu shërbejnë të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim feje, gjinie apo etnie, për çka dua t'i falënderoj edhe një herë përzemërsisht. Sukseset tona janë edhe fryt i përkushtimit të miqve tanë që pandërprerë po na mbështesin, andaj i falënderojmë dhe u jemi mirënjohës. Sfidat qe kishim na kanë bërë më të fortë dhe na kanë dhënë edhe më shumë kurajë, për të realizuar misionin tonë të shenjtë. Uroj që viti që po vjen, FSK-në ta gjejë edhe më të përgatitur profesionalisht dhe më afër synimit për të qenë pjesë e nismave të NATO-s, si një kontribuuese e denjë e sigurisë rajonale dhe globale në shërbim të paqes.

Në fund ju uroj shëndet, paqe dhe lumturi, juve dhe familjeve tuaja. Urime!

Komandanti i FSK-së
Gjenerallejtënant Kadri Kastrati

Ministri i Mbrojtjes së Kroacisë vizitoi MFSK-në

Kroacia do ta ndihmojë FSK-në për antërësimin në NATO



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, për një vizitë zyrtare, ditëmëparë, ka qëndruar ministri i Mbrojtjes i Ushtrisë së Kroacisë, Ante Kotromanoviq, i cili u prit me nderime të larta nga Togu i nderit dhe Orkestra frymore e FSK-së. Pas fotografisë së përbashkët, në hollin e Ministrisë, të dy ministrat biseduan kokë më kokë për të vazhduar takimin e përbashkët në nivel të zgjeruar të dy delegacioneve. Në takim mori pjesë edhe zv. ministri Shemsi Veseli, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Zymer Halimi, Bashkim Jashari, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Haxhi Shala, kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, ndërsa pjesë e delegacionit kroat ishin: Igor Gabriq, këshilltar i Ministrit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Jerko Letica, këshilltar i ministrit për Politika të Mbrojtjes, Marija Plesha Qadonic shefe e Protokollit, Zoran Drqa shef i Sektorit të Departamentit për Çështje të Sigurisë dhe ambasadori i Kroacisë në Kosovë, Zoran Vodopia.

Të dyja palët, nënshkruan planin dypalësh të bashkëpunimit për vitin 2013.

Ministri i FSK-së, mori mbështetje për bashkëpunim dypalësh (bilateral), mbështetje në rrafshin rajonal, si dhe mbështetje në rrugën e integrimit të Kosovës në NATO.

Ministri }eku,me këtërast tha: " Pata kënaqësinë e veçantë, ta pres ministrinë e Mbrojtjes së Kroacisë, Ante Kotromanoviq, mikun tim. Me Kroacinë në përgjithësi edhe me zotin Kotromanoviq na lidhë shumëçka e përbashkët, na lidhë e kaluara, lufta e përbashkët për Kroacinë, por edhe tani na lidh bashkëpunimi për ndërtimin e së ardhmes.

Me Kroacinë kemi një marrëveshje bashkëpunimi nga e cila ne po përfitojmë shumë, si nga infrastruktura e shkollimit ushtarak, nga përvoja në integrimin në NATO, nga përvoja në operacione paqeruajtëse, nga përvoja për menaxhimin e emergjencave, e sidomos nga përvoja e trajtimit të kategorive të dala nga lufta, ruajtjes dhe kultivimit të vlerave të luftës.

Neve me Kroacinë na lidhë edhe e ardhmja! Do të jemi bashkë në Unionin Evropian, bashkë do të jemi në NATO, bashkë do të jemi në operacione paqeruajtëse një ditë, bashkë do të kontribuojmë në ndërtimin dhe fuqizimin e paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit, këtu në rajonin tonë.

Sipas planit konkret për vitin 2013,pjesëtarët e FSK-së do të mund të shkollohen në 15 shkolla në Kroaci, pastaj në kurse të ndryshme si dhe në pesë fusha të shkëmbimit të përvojave në mes të Ministrisë sëFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë.

Mbështetje morëm edhe në rrafshin rajonal. Kroacia është një fuqi rajonale, lider rajonal në të gjitha fushat dhe Kroacia gjithmonë do të na ketë pranë, në të gjitha iniciativat dhe projektet rajonale në fushën e sigurisë. Mbështetja e tretë është në rrafshin e NATO-s, ku Kroacia si anëtare e NATO-s gjithmonë do ta mbështesë Kosovën, sidomos për agjendën e saj në NATO.

Ndërsa, ministri i Kroacisë, Ante Kotromanoviq, tha se ne kemi filluar bashkëpunimi midis dy vendeve dhe kjo na e lehtëson vazhdimin e bashkëpunimit. Ne jemi të interesuar që të krijojë një urë të mbrojtjes në mes të dy vendeve, duke bashkëpunuar në fushën e shkollimit, industrisë së mbrojtjes etj.me qëllim që FSK-ja të ngritët në një nivel më të lartë.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Viti 2012 i suksesshëm për FSK-në



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës Agim Çeku, sot në ambientet e Ministrisë mbajti një takimin përmbyllës me gazetarë, për vitin 2012. Në takim morën pjesë: zëvendësministri Shemsi Veseli, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj si dhe stafi i lartë i Ministrisë dhe FSK-së. Me këtë rast, ministri Agim Çeku pasi falënderoi mediet, për punën objektive dhe qasjen profesionale, në shkrimet e tyre korrekte për FSK-në si dhe KFOR-in, NATO-n, Gardën Kombëtare të Ajovës dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë për bashkëpunimin e mirë me FSK-në, ka vlerësuar realizimin në tërësi të objektivave të ministrisë për vitin 2012, të cilat kanë qenë të parapara në bazë të planit veprues të Ministrisë. Si rezultat i angazhimit të përgjithshëm, ky vit ishte vërtetë vit i suksesshëm për FSK-në, në arritjen e objektivave të cilat ishin: Aprovimi i Kapaciteteve të Përgjithshme Operacionale, nga ana e Këshillit Veri-Atlantik të NATO-s si dhe shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve për kryerjen e misionit kushtetues dhe në ndihmë autoriteteve civile dhe komuniteteve. Vazhdimi i ngritjes dhe ndërtimi i vlerave të identitetit dhe dukshmërisë-vizibilitetit të FSK-së, fuqizimi i bashkëpunimit dypalësh dhe rajonal, bashkëpunimi dhe partneriteti me NATO-n, dhe rishikimi i strukturës, misionit dhe detyrave të MFSK-së në kuadër të RSSS-së. Gjatë këtij viti kemi bërë përparime të dukshme drejt secilit objektiv, që ia kemi vënë vetes. Si tëarriturat-mëtëmaëdha te objektivi i parë, Ministri numëroi: Rishikimi i vazhdueshëm i progresit, krijimi i Qendrës rajonale të kërkim-shpëtimit, themelimi i kompanisë Model, Ngritja e korit të nënoficerëve, trajnime për operacione paqeruajtëse, ushtrimi fushor-Shqiponja 1, ushtrimi për zbarkim jashtë vendit, ushtrimi për komunikim strategjik në këto operacione, si: operacionet e EOD, ku ka pasur 357 intervenime, 36 intervenime të MKAB-së, 33 intervenime në zjarrëfikje, 35 zhbllokime rrugësh, trajnime të ndryshme nga instruktorë vendor dhe nga ata ndërkombëtar; instruktorë nga Ushtria Amerikane, Britania, Turqia, Holanda, etj. Gjatë këtij viti janë avancuar 40 oficerë, 115 nënoficerë dhe janë dekoruar 44 pjesëtarë për arritje të rezultateve të mira; një pjesëtarë, ka mbrojtur doktoraturën, 57 veta kanë mbrojt magjistraturën në lëmi të ndryshme dhe 76 veta kanë kryer Bachelor.

Arritja nga objektivi i dytë, është ndërtimi i identitetit kombëtar, ngritja dhe zhvillimi i standardeve dhe vlerave të FSK-së, sipas standardeve të NATO-s. FSK-ja është Forcë aktive dhe e dukshme, ka dhënë asistencë autoriteteve civile dhe mbështetje komuniteteve, asistencë mjekësore, ka marrë pjesë në shënimin e datave të rëndësishme, ka mbajtur ligjërata për vetëdijesimin nga minat në shkolla, deminimin humanitar, ku kanë pastruar 164.000 metra katror, dhe kanë shkatërruar 771 mjete të pashpërthyera, kultivimi i vlerave dhe identitetit kombëtar, si shënimi i 5,6 dhe 7 Marsit, Dita e Pavarësisë, Dita e Forcës, Uniforma e re, Orkestra frymore, dhe prezantimi i FSK-së jashtë vendit, parakalimi i FSK-së, më 28 Nëntor në Shqipëri, kampi veror në Krivollak, Marshimi në Holandë. etj.

Te objektivi tre, ministri potencoi bashkëpunimin bilateral dhe rajonal, si dhe nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit me Gjermaninë, Letoninë, Kroacinë, etj. Partner programin me Gardën Kombëtare të Ajovës, realizimin e vizitave të autoriteteve të huaja në MFSK-së dhe ato të FSK-së në vende të botës. Ndërsa nga objektivi 4, foli për Bashkëpunimin dhe partneritetin me NATO-n, KFOR-in, etj. Nga Objektivi 5, ministri foli për Rishikimin e SSS-së, "ky proces ka filluar në shkurt dhe është duke ecur sipas dinamikës".Ministri i FSK-së Agim Çeku foli edhe për disa projekte të planifikuara po nuk janë realizuar, me vetë shkakun se nuk kanë qenë prioritet për këtë vit, kanë mbetur të realizohen për vitin e ardhshëm. Ndërsa, për buxhetin për vitin 2012, ministri tha se nga 39.347, 258.00 në total, mbi gjysmën e këtyre mjeteve i kemi shpenzuar për shpenzime kapitale, pastaj për paga dhe shpenzime komunale, etj, dhe në total e kemi realizuar buxhetin, mbi 94 % të aluduar për këtë vit.

Ministri Agim Çeku shpalosi edhe prioritet për vitin 2013.


Në fund, në pyetjet e gazetarëve për të ardhmen e FSK-së, ministri Çeku ka thënë se pas rishikimit të strategjisë për siguri kombëtare, në qershor të vitit 2013, do të dilet me konkluza të reja, dhe se viti 2013 do të jetë vit i FSK-së. t'i bashkohet manifestimit gjithëkombëtar për 100-vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë.

Kundëradmirali Mark Montgomeri qëndroi për vizitë lamtumirëse në MFSK



Ministri Agim Çeku dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati pritën në takime të ndara kundëradmiralin Mark Montgomeri, Patrik Pierci, gjeneralbrigade Steven Daf dhe kolonelin Gjejms Kot. Zëvendësdrejtori i Politikave, Planeve dhe Strategjive në Komandën Amerikane për Evropë (EUCOM), kundëradmirali Mark Montogomeri falënderoi ministrin dhe komandantin për bashkëpunimin e deritanishëm si dhe konfirmoi bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme për FSK-në edhe në të ardhmen. Admirali Mongomeri i njoftoi ministrin dhe komandantin e FSK-së me kundëradmiralin Patrik Pierci, i cili do ta zëvendësojë atë nëdetyrë ederitashme. Mongomery u shprehur i bindur se marrëdhëniet ndërmjet EUCOM-it dhe MFSK-së do të vazhdojnë në të njëjtin nivel edhe në të ardhmen. Ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati falënderuan admiralin Montgomeri për angazhimin e tij në drejtim të forcimit të raporteve ndërmjet EUCOM-it dhe FSK-së, për kohën sa ishte në detyrën e zëvendësdrejtorit të Politikave, Planeve dhe Strategjive në Komandën Amerikane për Evropë dhe njëherit i shprehen mirëseardhje kundëradmiralit Patrik Pierci, duke i premtuar angazhim në drejtim të thellimit dhe vazhdimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit. Kjo ishte vizita e fundit e admiralit Montgomeri në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në detyrën e zëvendësdrejtorit të Politikave, Planeve dhe Strategjive në Komandën Amerikane për Evropë (EUCOM).

Gjenerali Bashkim Jashari priti gjeneralin amerikan Peter Vangjel



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Prishtinë, gjeneralbrigade Bashkim Jashari, inspektor gjeneral i FSK-së, ka pritur në një takim pune, inspektorin gjeneral të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjenerallejtënant Peter M. Vangjel me bashkëpunëtorë. Gjenerali Bashkim Jashari e ka njoftuar homologun e tij amerikan, për të arriturat e Inspektoratit të FSK-së. Gjatë takimit u bisedua për bashkëpunimin dypalësh ndërmjet dy inspektorateve, të FSK-së dhe Ushtrisë së SHBA-ve, të dala nga memorandumi i bashkëpunimit,u bisedua për rolin, misionin, përballjen e inspektoratit me sfidat e reja, përshtatjen e kapaciteteve dhe funksionet karshi trendëve të reja kudo në botë. Inspektori i Ushtrisë Amerikane, gjenerallejtënant Peter Vangjel ka premtuar për trajnimin e personelit të inspektoratit të FSK-së, në Shkollën e Inspektorëve të Ushtrisë së SHBA-ve. Gjeneral brigade Bashkim Jashari ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjeneralin Peter Vangjel, për ndihmën e Ushtrisë Amerikane për FSK-në. Inspektori gjeneral i Ushtrisë së SHBA-ve, gjenerallejtënant Peter M. Vangjel së bashku me një delegacion të lartë të Ushtrisë Amerikane po qëndron në Kosovë, në kuadër të një vizite pune. Në përbërje të delegacionit të Agjencisë së Inspektoratit të SHBA-ve janë zyrtarët më të lartë, përfshi edhe kryeinspektorin e kësaj agjencie, për Ushtrinë e SHBA-ve, në kampin "Bonstill". Në fund, të dy bashkëbiseduesit u pajtuan që të vazhdojnë bashkëpunimin e dyanshëm në të gjitha nivelet.

Gjeneralmajor Rrahman Rama qëndroi për një vizitë zyrtare në Turqi



Zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneralmajor Rrahman Rama së bashku me drejtorin e Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, kolonel Ilir Qeriqi dhe drejtorin e Departamentit të Personelit, kolonel Skënder Zhitia, bazuar në planin bilateral për bashkëpunim me Ushtrinë e Turqisë, për vitin 2012, kanë vizituar Korpusin e 3-të (Korpusi i 3-të i NATO-s për zbarkime të shpejta)dhe Brigadën e 66 -të Mekanizuar në Stamboll, ku u pritën nga gjenerali Yalçin Ataman, (gjeneral me 4 yje), komandant i Armatës së Parë të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, nga gjenerallejtënant Kenan Hüsnüoglu, komandant i Korpusit të 3-tëdhe nga Gjeneralbrigade Basak. Delegacioni i FSK-së, është njoftuar me përgatitjet e përgjithshme të Korpusit të 3-të, para zbarkimit. Të dy delegacionet kanë biseduar për shkëmbimin e përvojave dy palësh, në këtë fushë, dhe për mundësinë e përfshirjes së oficerëve të stafit të FSK-së, në kuadër të këtij korpusi.

FSK-ja shënoi Ditën e Forcës në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë

Kuadratet e FSK-së parakalojnë me uniforma të reja



Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, me një manifestim solemn të mbajtur në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, kanë shënuar Ditën e FSK-së, shënimi i së cilës këtë vit përkoi me shënimin jubilar të 100 -vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.
Ceremonia filloi me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të FSK-së, nga presidentja Atifete Jahjaga dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati.
I pari që përshëndeti "Ditën e Forcës" ishte kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i cili, tha: " Ndihem krenar që sot jam këtu para jush, në këtë moment kaq të rëndësishëm të historisë së Republikës së Kosovës. Kjo ceremoni është edhe më madhështore, sepse besoj se të gjithë ndajmë së bashku ndjenjën e krenarisë dhe patriotizmit, por edhe të kujtimit për të gjithë ata që na ndihmuan në këtë rrugëtim të gjatë, që dhanë jetën e tyre dhe që janë më meritorët që ne sot jemi këtu.
Sot, po shënojmë Ditën e Forcës me uniforma të reja, që do të jetë simbol identifikues i FSK-së dhe karakterit tonë shtetëror. FSK-ja është duke punuar me përkushtim për përmbushjen e standardeve më të larta të NATO-s, që në një të ardhme të afërt të jemi anëtar të NATO-s dhe kontribuues të paqes dhe stabilitetit në rajon, por edhe në botë.
Ndërsa, presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, tha:"Sot, me krenari po shënojmë Ditën e Forcës së Sigurisë së Kosovës e cila falë punës së palodhshme të pjesëtarëve të saj është institucioni më i respektuar i Republikës së Kosovës. Po festojmë suksesin tonë të përKosovës, duke iu dalë në ndihmë qytetarëve të vendit pa dallime. Për profesionalizmin e FSK-së dhe ndërtimin e kapaciteteve të saj, si dhe për shkollimin e kuadrove të reja që janë rreshtuar në radhët e saj, e falënderojmë në mënyrë të posaçme NATO-n dhe forcën e saj paqeruajtëse në Kosovë si dhe Gardën Kombëtare amerikane, në veçanti atë të shtetit amerikan të Ajovës (Iowas). Nën mbikëqyrjen e tyre Forca e Sigurisë së Kosovës jo vetëm që ka përmbushur pritjet, por i ka tejkaluar ato duke u aftësuar, që në një të ardhme të afërt të bëhet pjesë e Partneritetit për Paqe dhe anëtare me të drejta të plota e NATO-s.
Në ceremoninë e Ditës së Forcës së Sigurisë, për bashkëpunimin e mirë me FSK-në dhe për të arriturat e FSK-së, foli edhe kundëradmirali amerikan Mark Mongomeri.
Po ashtu një fjalim për të arriturat e





Kjo datë e gjen FSK-në me rezultate të shumta, që i ka arritur në kryerjen e detyrave dhe realizimit të objektivave, sipas planifikimit të dinamikës së ngritjes dhe zhvillimit.
Viti 2012 ishte një vit i angazhimeve dhe sukseseve të mëdha në shumë fusha njëkohësisht, si: kompletimi i strukturës aktive; përzgjedhja e kadetëve për Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së; mbajta e ushtrimit fushor "Shqiponja 1" zbarkimi në Krivollak të Maqedonisë, në ushtrimin "Reagimi ndaj krizave" ; zbarkimi në Danimarkë, në ushtrimin fushor të Njësisë për Reagim ndaj Krizave; zbarkimi i kadetëve në Krivollak të Maqedonisë, në një ushtrim të përbashkët me shumë shtete të rajonit dhe ushtri anëtare të NATO-s; marshimi tradicional në Nimengen të Holandës; njësitë e çminimit kanë pastruar 701,669 metra katrorë, janë gjetur 2085 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera.
Njësia për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera (EOD) ka intervenuar në 337 raste, ku ka shkatërruar 402 mjete të ndryshme eksplozive. Njësitë e zjarrëfikjes të FSK-së janë angazhuar në shuarjen e zjarreve në zona të ndryshme malore.
Në fushën e bashkëpunimit civil-ushtarak, FSK është angazhuar në realizimin projekteve humanitare, siç janë: aksioni për dhurimin e gjakut, hapja e rrugëve të reja, pastrimi i lumenjve, rregullimi i oborreve shkollore dhe terreneve sportive, ndërtimi i urave, shtëpive të banimit, ndihma mjekësore për banorë të komuniteteve jo shqiptare.
Sipas vlerësimeve të përbashkëta të KFOR-it dhe FSK-së, ne i kemi arritur kapacitetet e plota operacionale (KPO). Në nëntor të viti 2011, KOMKFOR-i sipas zinxhirit të vet komandues ka raportuar në NATO, se FSK-ja ka realizuar pesë (5) objektiva dhe 132 kritere të parashtruara, si kritere matëse që FSK-ja të jetë operacionale.
FSK-ja sot ka strukturë funksionale për përmbushjen e misionit që ka. Ajo mund të kryejë të gjitha detyrat që i caktohen. Ne jemi shumë optimist për të ardhmen e FSK-së, si dhe për pozitën e saj në raporte me mekanizmat e NATO-s. Presim që Këshilli Veri - Atlantik i NATO-s, të del me Deklaratë Politike për deklarimin e Kapaciteteve të Plota



bim të përvojave. Bashkëpunimi me KFOR-in ka vazhduar me kontakte të rregullta dhe me Ekipin Këshillues Ushtarak në FSK.
Ky bashkëpunim i thelluar me të drejtë është vlerësuar si bashkëpunim i drejtpërdrejtë me NATO-n. Kemi pasur takime me karakter ndërkombëtar dhe vizita pune të shefave të shtabeve të



Operacionale dhe raportin e ardhshëm në mes Kosovës, NATO-s dhe KFOR-it. Perspektiva zhvillimore e FSK-së, do të trajtohet gjatë procesit të Rishikimit të Sektorit të Strategjisë së Sigurisë të Kosovës, në bashkëpunim me partnerët relevant ndërkombëtarë.
FSK-ja ka zhvilluar bashkëpunim me ushtritë e vendeve mike në këmushtrive mike si me: Mal të Zi, Shqipëri, Maqedoni, Ajova- SHBA, Itali, Kroaci, Turqi etj. Në këto takime janë diskutuar planet e veprimit të bashkëpunimit për vitin 2013.
Një vend të posaçëm zë bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Ajovës nga SHBA-të, që po jep ndihmë të pakursyer në trajnime të përbashkëta, si dhe shkëmbim delegacionesh, që ishin në funksion të thellimit të këtij bashkëpunimi. Rezultat i bashkëpunimit dhe faktorizimit të FSK-së, është edhe arritja e dërgimit dhe emërimit të atasheut të parë ushtarak të FSK-së në SHBA, pastaj në Gjermani dhe së shpejti edhe në Belgjikë. Këtë muaj themeluam dhe promovuam Task Forcën (njësi e posaçme dhe e specializuar) e Kërkim-Shpëtimit, si njësi e intervenimit operativ jashtë vendit.
Në avancim të këtij projekti po ashtu përuruam edhe Qendrën Regjionale Trajnuese të Kërkim-Shpëtimit. Kjo qendër ka karakter regjional dhe është ngritur me ndihmën e SHBA-ve.
Zhvillimi dhe ngritja e strukturës së FSK-së është duke u bërë me standarde të NATO-s, që mundëson bashkëpunimin edhe më të mirë me vendet e rajonit dhe vendet që janë anëtare të NATO-s. Kjo ngritje është rezultat i punës së përbashkët dhe ndihmës së pakursyer të partnerëve ndërkombëtarë. Edhe gjatë këtij viti FSK-ja ka pasur ndihmën e vendeve mike, qoftë me donacione të ndryshme, si: mjete dhe teknikë, por edhe me dua të falënderoj të gjitha vendet dhe ushtritë, që ndihmuan FSK-në në çdo aspekt.
Për arritje të jashtëzakonshme u dekoruan ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, nga presidentja, ministri dhe komandanti i FSK-së.







bashkët, të arritur me shumë mund dhe sakrificë, por mbi të gjitha po i përkulemi përkushtimit të pashembullt të pjesëtarëve të kësaj force, për t'iu vënë në shërbim qytetarëve të vendit tonë dhe për t'u bërë kontribuues i paqes, në Kosovë dhe rajon. Brenda një kohe të shkurtër, FSK-ja u shndërrua në institucionin më të besueshëm të Republikës së FSK-së, e mbajti komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili në mes tjerash tha: "Sot jemi duke shënuar Ditën e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me moton: Me Forcën - Për Kosovën. Kjo festë, këtë vit përkonë me manifestimin e madh të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, gjë që e bën edhe më madhështore këtë ditë.

Në Ditën e Forcës jepen medalje për kontribut dhënë FSK-së

Presidentja e Republikës së Kosovës, dekoron komandantin e FSK-së

Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga, në bazë të nenit 84 pika 28 të Kushtetutës së Kosovës, të nenit 7, të Ligjit për Dhënien e Dekoratave, si dhe në bazë të neneve 3,4 dhe 12 të Rregullores mbi Dekoratat , Urdhrat dhe Titujt e Nderit, merr këtë vendim:

Për dekorimin e komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me Medaljen Presidenciale të Meritave, për pjesëmarrjen në luftë dhe përkushtimin e tij për ngritjen, ndërtimin dhe zhvillimin e TMK-së dhe FSK-së. Medalja Presidenciale e Meritave u jepet personave që me punën e tyre kanë kontribuar në fusha të veçanta si: arsim, shkencë, kulturë, rini, sport,siguri, shërbim civil.

Ministri Agim Çeku ka dekoruar me medaljen për "Shërbim Meritor" kundëradmiralin Mark Mongomeri

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës Agim Çeku duke u bazuar në nenin 3.1. të Ligjit, nr. 03/L-045 për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe bazuar në nenin 24 paragrafi 2 të Rregullores nr. 03/2010 mbi Shpërblimet dhe Dekoratat e FSK-së, nxjerr këtë vendim:

Me medaljen për "Shërbim Meritor ", ka dekoruar kundëradmiralin Mark Mongomeri.

Medalja i jepet në shenjë falënderimi për kontributin e Tij të veçantë dhe përkrahjen e pakursyer për



Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe FSK-në.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës duke marrë parasysh nenet 4,21,22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82,21 tetor 2010, si dhe duke u bazuar në nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-045 për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcës 5 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive



(22.03.2011), po ashtu bazuar në Rregulloren nr. 03/2010 mbi Shpërblimet dhe Dekoratat për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nxjerr këtë vendim:

Me medalje për "Shërbim të Shquar" për përkushtim dhe kontribut në ngritjen dhe zhvillimin e MFSK-së dhe FSK-së dekorohen:

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati, Shkëlzen Syla-sekretari i përgjithshëm, gjeneralmajor Rrahman Rama-KOMFT , gjeneral brigade Bashkim Jashari-inspektor gjeneral i FSK-së, gjeneral brigade Zymer Halimi DO/MFSK dhe gjeneral brigade Nazmi Brahimaj-KOM-BRSH



Ndërsa me medalje për "Shërbim Meritor" për përkushtim dhe performancë meritore në detyrë, dekorohen: nënkolonel Agim Vrellaku-inspektor i FSK-së, major Remzije Morina-DPP/MFSK, major Sabedin Zejnullahu -KFT, kapter Lirim Hamiti-komandant kompanie dhe rreshter Shemsije Islami-DO/MFSK .

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati jep urdhër për dhënie të medaljeve

Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-082 për Shërbim në FSK, mbi Dekorimet, Shpërblimet dhe Lavdërimet; si dhe nenit 22 dhe nenit 24, pika 3, të Rregullores nr. 03/2012 "Mbi Shpërblimet dhe Dekoratat për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me rastin e shënimit të "Ditës së Forcës më-27 Nëntor", komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, jep medaljen "Arritje e Dalluar" me motivacion performancë të dalluar gjatë detyrës, për pjesëtarët: gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, nënkolonel Bajram Uka, toger Fatmir Kajtazi, rreshter Urim Gjoshi, rreshter Xhevdet Zymberi, rreshter Lulzim Rama, rreshter Xhevat Rama, rreshter Afrim Shala, tetar Burhan Daci, tetar Xhevdet Mustafa, tetar Agron Murati, tetar Mentor Jetullahu dhe tetar Xhelal Durmishi, ndërsa me medaljen "E ardhmja fillon këtu" me motivacionin kryerjen e demonstrimeve të shkëlqyera në program akademike dhe trajnuese, për pjesëtarët: major Berat Shala, kapiten Tomë Lleshi, rreshter Shera Kulla-Murati dhe Rreshter Naim Bahtiri, me medalje "Qitës i Dalluar" me motivacion kualifikimi në nivelin e ekspertit të armëve, për kapiten Ramiz Bytyqi, me medaljen "Shërbim" me motivacion shërbim dhe sjellje të ndershme gjatë tri viteve të shërbimit, për pjesëtarët: nënkolonel Fadil Hadërgjonaj, nënkolonel Haki Hoti, major Arife Halili, kapiten Bujar Istogu, rreshter-major Leonora Nimani, kapter Hiser Muja, rreshter Fitnete Sefa, rreshter Shpresa Gashi dhe tetar Daut Ahmeti. Urdhri hyn në fuqi, më 26 nëntor 2012.

Intervistë me oficerin kanadez Wayne Gauthier, këshilltar i Ekipit Këshillues të NATO-s, për FSK-në

Dhurata për fëmijët e Qendrës së Përkujdesjes së Nënës dhe Fëmijëve Në Prishtinë

Forca Jonë: Sa është e gjatë tradita e dhuratave për Krishtlindje, për fëmijët në jetimore?

Wayne Gauthier: Në vitet e kaluara; amerikanët, kanadezët dhe gjermanët e kanë filluar një traditë për festimin e Krishtlindjes në Qendrën e Përkujdesjes së Nënës dhe Fëmijës, në Prishtinë. Ne vetëm po e vazhdojmë këtë traditë. Edhe sivjet do të bëjmë një organizim të tillë, ku për nder të kësaj feste do të shpërndajmë dhurata .

Forca Jonë: Kujt do t'i dhuroni dhurata këtë vit ?

Wayne Gauthier: Edhe këtë vit dhuratat do t'ia japim Qendrës së Përkujdesjes së Nënës dhe Fëmijës, ku për çdo vit më datën 22 dhjetor organizohet festa e Krishtlindjes. Me këtë rast, secilit prej fëmijëve ua japim dhuratën e vet. Në këtë mënyrë "Babadimri "sigurohet që asnjë fëmijë të mos mbetet pa dhurata.

Forca Jonë: Në Kanada, festa e Krishtlindjes është e veçantë, çka mund të na thoni për këtë?

Wayne Gauthier; Në kulturën tonë, Krishtlindja është festë shumë e veçantë, posaçërisht për fëmijët të cilëve u japim dhurata. Meqë gjatë kësaj feste ne nuk jemi në shtëpi me fëmijët tanë, atëherë e shfrytëzojmë mundësinë për t'ju dhënë dhurata fëmijëve tjerë, duke i bërë kështu të lumtur në këtë fundviti.

Forca Jonë: A mund të na thoni diçka për mënyrën e shpërndarjes së dhuratave?

Wayne Gauthier: Drejtoresha e Qendrës i ka identifikuar rreth 40 fëmijë dhe gjërat për të cilat ata kanë më së shumti nevojë, e



që zakonisht janë xhaketa, këpucë, triko e të tjera. Në kuzhinën e KFOR-it, në pemën e Krishtlindjes, përveç zbukurimeve tjera janë të vendosura edhe 40 kartolina me engjëj, një engjëll për secilin fëmijë, ku është i shkruar emri i fëmijës, mosha dhe çfarë dëshiron fëmija. Pastaj ne e marrim një kartolinë, e blejmë atë dhuratë të cilën e dëshiron fëmija dhe e mbështjellim me letër dekorative.

Forca Jonë: Kush do të marrë pjesë në shpërndarjen e dhuratave nga përfaqësuesit e KFOR-it ?

Wayne Gauthier: Organizimi i dhënies së dhuratave për festën e Krishtlindjes bëhet nga kontingjenti amerikan, kanadez dhe ai gjerman, të cilët punojnë së bashku për ta mbështetur Qendrën e Përkujdesjes së Nënës dhe Fëmijës. Zakonisht, amerikanët dhe gjermanët i mbulojnë shpenzimet ditore të qendrës, ndërsa kanadezët ndihmojnë në raste të veçanta.

Në fund, zotëri oficer ju falënderojmë për këtë gjest vërtetë human dhe njerëzor, që po bëni me rastin e festës së Krishtlindjes dhe iu urojmë edhe juve Krishtlindjen!

Intervistë me major Remzije Morina, pjesëtare e Forcës së Sigurisë së Kosovës

14 vjet me uniformë ushtarake

"Uniforma e ushtarakut ka qenë shoqëruesi im më i mirë, si në kohën e luftës po ashtu edhe në kohën e paqes. Nuk do ta ndërroja këtë profesion për asgjë tjetër në botë, sepse ky është profesioni më adekuat dhe që secilin ushtarak e bën të ndjehet krenar që i shërben vendit në mënyra dhe qëllime të ndryshme për t'i realizuar synimet dhe obligimet shtetërore"

Major Remzije Morina nga Qikatova e Drenasit është pjesëtare e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila tani punon si oficere për Plane dhe Programe të Buxhetit në Departamentin e Financave, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ajo ka 14 vite përvojë ushtarake dhe po t'i jepej mundësia të zgjedhë edhe njëherë profesionin e saj, ajo asnjëherë nuk do ta ndryshonte mendimin se profesioni i ushtarakut është ai që i përgjigjet plotësisht.

" Nuk e kam të vështirë jetën ushtarake, duke pasur parasysh që ushtarakët në çdo vend demokratik kryesojnë listat e preferencave publike për demonstrim të tipareve si; nderi, përkushtimi, profesionalizmi, fisnikëria, ndjenja e detyrës etj" u shpreh major Morina.

Major Morina për herë të parë kishte veshur uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në korrik të vitit 1998, ku ishte inkuadruar në radhët e UÇK-së, në Zonën Operative të



Drenicës, përkatësisht në Brigadën 114"Fehmi Lladrovci", në Dritan (ish Dobroshec).

"Meqë Kosova ishte në një gjendje lufte, mua ndërgjegjja më dha urdhër për mobilizim në UÇK. Njëherësh kjo është edhe periudha më e lumtur në historinë e jetës sime dhe nuk do ta ndërroja me asnjë pasuri tjetër në botë. Më të vërtetë ka qenë nder dhe kënaqësi për mua që isha pjesë e kësaj ushtrie, e cila i tregoi adresën e saktë për rrugën e lirisë popullit shqiptar".

Gjatë kësaj periudhe i kishin propozuar të punonte si kontabiliste në nivel të brigadës, por e kishte refuzuar sepse nuk dëshironte detyrë tjetër përveç të ushtares. Në mars të vitit 2000 fillon punën në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së, në Departamentin e Komunikimit. Pastaj pas një viti kalon në Departamentin e Inspektoratit. Ndërsa në vitin 2003, pas disa ristrukturimeve në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së, meqë ishte ekonomiste e diplomuar emërohet me detyrë si oficere e Buxhetit në Departamentin e Financave, ku edhe gradohet me gradën e Majorit. Gjatë kësaj kohe ajo ka përfunduar trajnime nga fusha të ndryshme si: në atë të auditimit, menaxhimit të financave publike, menaxhimit të projekteve etj. Major Remzije Morina është njëra nga oficerët të cilës iu nda mirënjohja për "Shërbim të Meritur" më 26 Nëntor në Ditën e Forcës.

"Shpërblimi për punën e mirë është motiv për të bërë më shumë. Edhe në rrethana normale kur merr një dhuratë ndihesh mirë. Marrja e medaljes për "Shërbim Meritor"për mua është edhe më madhështore, meqenëse vjen në vitin jubilar që përkon me 100-vjetorin e shpalljes së Republikës së Shqipërisë, dhe përvjetorin e festave të shumëfishta në Kosovë. Kjo për mua përveç që është një motiv i rëndësishëm, është edhe më shumë obligim që të vazhdoj të punoj gjithnjë me përkushtim në marrjen e detyrave dhe përgjegjësive, në raport të drejt me objektivat e FSK-së". Remzije Morina përveç që është një oficere e zonja në Forcën e Sigurisë së Kosovës, ajo, po ashtu, ka treguar sukses edhe në ngritjen e saj akademike si magjistër e ekonomisë. Ka përfunduar studimet postdiplomike në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Ekonomik, drejtimi "Menaxhment dhe Informatikë", ku edhe e ka mbrojtur temën ,,Menaxhimi i burimeve njerëzore në FSK".

Jeta civile dhe ajo ushtarake dallojnë dukshëm për major Remzijen.

"Jetën civile, pothuajse, e kam të ndarë krejtësisht nga jeta ushtarake. "Jam pjesë e përgjegjësive dhe obligimeve në familje, sepse dëshira për të sfiduar nuk më mungon, por mbështetja e familjes ka qenë për mua motiv dhe alternativë në jetën time".

Duke u bazuar në përvojën e saj që nga lufta e deri më sot, ajo ka kaluar shumë sfida dhe është përballur më shumë vështirësi, por njëkohësisht nuk i kanë munguar edhe sukseset, si ngritja kohë pas kohe në karrierë. Por që të gjitha këto ajo i ka arritur falë përkushtimit të madh, motivit të lart për realizimin e qëllimit të saj, mbështetjes së vazhdueshme të familjes si shtylla kryesore në jetë dhe po ashtu edhe të miqve e shoqërisë që nuk i kanë munguar asnjëherë.

Major Remzije Morina nuk ngurroi që për pjesëtarët të cilët tashmë janë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe ata të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e saj të japë edhe një porosi." Që të gjithë të jenë në shërbim të dijës, le të dëgjojnë atë lloj të „muzikës" e cila ndikon në zhvillimin e karakterit dhe personalitetit të tyre. Guximi dhe trimëria luajnë një rol shumë më rëndësi, varësisht se çfarë ata zgjedhin në shkollimin e mëtejmë. Le të jenë model i vetive më të mira për gjeneratat e ardhshme, sepse edukimi dhe shkollimi i mirë japin edhe oficerë të mirë. Fundja, shkollimi është parametri me premtues i së ardhmes" përfundoi major Remzije Morina, oficere për Plane dhe Programe të Buxhetit, në Departamentin e Financave në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Intervistë me toger Jeton Ahmeti, pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës

Oficeri i FSK-së, Qytetar Nderi i qytetit 'Huntsville-Alabama' të SHBA-ve

"Gjithçka që kam arritur deri me sot është meritë e QSU-së, mund të them se QSU ka qenë çelësi i të gjitha sukseseve të mija sado të vogla të cilat i kam pasur gjatë dhe pas diplomimit tim"

Toger Jeton Ahmeti është pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe punon si udhëheqës i Togut të Dytë, Kompanisë B të Batalionit të Tretë, në Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë.

Shkollimi i tij në Qendrën për Studime Universitare (QSU) ka qenë bazamenti i suksesit dhe arritjeve e sfidave të cilat Ahmeti i ka kaluar që nga fillimi i tij si kadet e deri në promovimin e tij si toger i FSK-së. "Gjithçka që kam arritur deri më sot është meritë e QSU-së. Mund të them se QSU ka qenë çelësi i të gjitha sukseseve, sado të vogla, të cilat i kam pasur gjatë dhe pas diplomimit tim".

Jeton Ahmeti ishte shpallur edhe "Qytetar nderi" i qytetit Huntsville të Alabamës më datë 5 qershor 2010 dhe kjo për të ishte një satisfaksion, sepse jo çdo ditë mund të merrej një titull i tillë, e aq më tepër në një moshë të re siç ishte Jetoni. Në fakt ky çmim nuk iu shtua vetëm arkivit të kadet Ahmetit, i cili në atë kohe ende ishte kadet i QSU-së, por ky çmim iu shtua edhe FSK-së si njëra ndër sukseset e pjesëtarëve të saj.

"Për arsye të arritjeve akademike, fizike dhe të udhëheqësit ushtarak, si njeri ndër studentët më të dalluar gjatë trajnimit, në të njëjtën kohë asistent i instruktorëve amerikan për CCNA rrjeta kompjuterike, shefi i Zyrës për Studentë Ndërkombëtarë zotëri Walter R. Andrae, më ka propozuar për këtë çmim, i cili bën të ndihem shumë krenar, për të cilin iu detyrohem të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës, pa gjakun dhe sakrificën e të cilëve nuk do të isha këtu" thotë Ahmeti.

Jeton Ahmeti ka përfunduar Shkencat Kompjuterike në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), ku edhe aty gjatë studimeve ka qenë njëri ndër studentët më të dalluar, për këtë e dëshmon edhe suksesi që kishte arritur në Kampionatin Evropian të Robotikës "Euroby 2008" në Linz të Austrisë në vitin 2008, ku kishte marr vendin e 3-të.

"Unë së bashku me Toger Faton Bekteshin gjithashtu pjesëtar i FSK-së, në ekipin e UBT-së ku koordinator ishte Prof. Dr. Artan Dermaku kemi pasur fatin ta prezantojmë Kosovën për herë të parë në garat evropiane të robotikës, ku në mesin e 16 ekipeve evropiane kemi zënë vendin e 3-të. Konkurrent kemi pasur prof. dr. të kompjuterikes, mirëpo me punën dhe mundin tonë kemi arritur të radhitemi si ekipi i 3-të në Evropë". Po ashtu ai ka marr edhe Medaljen e Artë "German Proficiency Badge-GPB " ku ka tejkaluar standardet fizike të cilat janë paraparë në këtë garë të organizuar nga Zyra Ndërlidhëse gjermane në Fort Gordon, SHBA në vitin 2010.

Ka përfunduar trajnime dhe është certifikuar në fusha të ndryshme profesionale si kursi bazik për sinjale, siguria e të dhënave, rrjetet kompjuterike, të gjitha të përfunduara në Fort Gordon në SHBA gjatë vitit 2010. Trajnimin për Server 2008 R2, trajnimin për planifikim operacional, taktika për njësi të vogla etj. Është duke i vazhduar studimet master për Inxhinieri Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës.

Për Jetonin është krenari që ka qenë vazhdimësi e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës pasi që tri vite ai i ka kaluar si kadet në TMK. Prej fillimit të punës si oficer në FSK, ka punuar dy vite si oficer i Planifikimit në G6, në Komandën e Forcave Tokësore, ndërsa tash është transferuar në Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë për ta sfiduar vetën edhe me trupa.

"Jam udhëheqës i Togut të Dytë, Kompanisë B në Batalionin e Tretë në BRSH. Detyra ime është planifikimi, trajnimi, këshillimi dhe përgatitja e 30 pjesëtarëve që të jenë të gatshëm t'i përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë të cilat kërkohen prej tyre".



Ahmeti kishte pasur disa oferta për punë në fushën e kompjuterikes, por asnjërën nga to nuk i kishte pranuar sepse uniforma e FSK-së është mburrje dhe krenari për të. "Puna me trupa është një ndjenjë e veçantë dhe të bënë të ndjehesh krenar çdo ditë e më shumë, madje në asnjë punë nuk besoj se do mund të jepja kontribut më të madh se në FSK " është shprehur Ahmeti. Po përveç përkushtimit të tij në punën që bën Jetoni është edhe prind i përkushtuar. Ai është i martuar me pjesëtaren e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) Hava Sekiraqen dhe kanë një djalë të quajtur Diell

" Në jetën civile i përkushtohem më shumë familjes dhe djalit të vogël Diellit tre muajsh, studimeve dhe ndonjëherë kur me jepet rasti udhëtimeve brenda dhe jashtë Kosovës, ndërsa në jetën ushtarake duhet të jem i përkushtuar kurdo që kërkohet prej meje, planifikimi, ushtrimet, trajnimet, këshillimet, të cilat janë vetëm disa nga elementet që e bëjnë më sfiduese jetën ushtarake, mirëpo edhe kjo ka anët e saj pozitive" përfundoi Jeton Ahmeti.

U certifikuan edhe 33 pjesëtarë të FSK-së në kursin "Lider Luftarak"



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj, u bë certifikimi i 33 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kanë kryer kursin e lartë për lider luftarak. Në ceremoni morën pjesë, ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjeneralmajor Rrahman Rama, zv.ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës zonj. Kelly Degnan, kolonel James Kott atasheu ushtarak i SHBA-ve, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, Zymer Halimi dhe Nazmi Brahimaj, kolonelët; Eoicik, Blake Storey, Bondstel dhe oficerë e ushtarak të FSK-së dhe KFOR-it. Ministri i FSK-së Agim Çeku, ka përshëndet të pranishmit e sidomos Shtete e Bashkuara të Amerikës, për këtë që po bëjnë, në trajnimet, shkollimin dhe ngritjen profesionale të FSK-së. Ai tha: sot FSK-së, po i bashkohen edhe 33 pjesëtarë të diplomuar për Lider luftarak, ky është edhe një sukses i madh i FSK-së, në ngritjen e korit të liderit luftarak që është bazë kryesore e çdo ushtrie moderne. Certifikimin e sotëm e konsideroj një ngjarje të rëndësishme, për arsye se këta nënoficerë të përgatitur po i shtohen radhës së sukseseve të cilat FSK-ja ka arritur gjatë këtij viti. E rëndësishme është se FSK-ja i ka edhe 33 nënoficerë luftarak të përgatitur për misione që kërkohen. Ministri Çeku, nënoficerëve të certifikuar u tha: ju jeni udhëheqës të parë të ushtarëve, ushtarët presin nga ju detyra, ju jeni bartës kryesor të ushtrisë, ju do të përgatitni ushtarët në detyra luftarake. Ne jetojmë në paqe dhe do zoti të jetojmë gjatë në paqe, por një gjë duhet të mbani në mend dhe ta keni detyrë; të përgatiteni se një ditë do të sprovoheni në detyrat që ju keni mësuar dhe përgatitë nga ky trajnim. Dy gjëra që ju duhet të mbani në mend gjithherë, janë: Zbatimi i detyrës dhe kujdesi ndaj ushtarëve tuaj. Në emër të ambasadores së SHBA-ve, Jacobson dhe Admiralit Stavridis, Komandantit të komandës Evropiane, nënoficerëve, me një fjalë përshëndetëse, ju drejtua kolonel James Kott, atasheu ushtarak i SHBA-ve, në Prishtinë, i cili fjalimin e lexoi në gjuhën shqipe. "Formimi i korpusit të nënoficerëve të trajnuar dhe të përgatitur mirë është një detyrë thelbësore e çdo ushtrie. Ne jemi shumë krenar, që Shtetet e Bashkuara kanë luajtur një rol të sigurojnë që sot FSK-ja të ketë 33 nënoficerë të trajnuar rishtazi, të cilët janë mirë të përgatitur për të udhëhequr dhe trajnuar skuadrat, togjet dhe kompanitë e tyre. Ne jemi gjithashtu krenarë se kursi ka përfshirë një pjesëmarrës nga partneri rajonal, Shqipëria. Unë gjithashtu dua të theksojë se ky trajnim i vlefshëm është bërë i mundur nëpërmjet Fondit të SHBA-së për financimin e ushtrive mike, i koordinuar nga ekipi i Zyrës për bashkëpunim të Mbrojtjes. Dhe sigurisht që asgjë nga kjo nuk kishte me qenë e mundur pa inkurajimin, interesin dhe përfshirjen e lidershipit të FSK-së. Në fund kolonel Kott, tha se karakteri i nënoficerit dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës si një organizatë duhet ti ketë këto elemente dalluese, të jetë: Udhëheqës, Kompetent dhe i Disiplinuar. Përgjegjësi kryesore e nënoficerit janë; realizimi i misionit dhe mirëqenia e ushtarëve të mi. Ndërsa, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, komandant i KDS-së, tha: Ne po shënojmë edhe një sukses tjetër në lëmin e trajnimeve duke përfunduar këtë kurs, që është ndër kurset më të avancuara që kemi mbajtur deri më tani në KDS dhe në përgjithësi në FSK. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes është duke vazhduar trajnimet bilaterale me Ushtrinë e SHBA-së, përmes programeve të edukimit dhe stërvitjeve për të zhvilluar dhe përgatitur udhëheqës për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në fundu shpallën edhe kadetët më të mirë, tëcilët u nderuan me mirënjohje, për arritjen e rezultateve gjatë kryerjes së kursit të lart, për Lider Luftarak.



Orkestra Frymore e FSK-së dha një koncert festiv për Vitin e Ri

Me rastin e festave të fund vitit, Orkestra Frymore e FSK-së ka dhënë një koncert festiv. Në koncert morën pjesë, ministri Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFOR-it, ish-ministri i FSK-së Fehmi Mujota, ambasadori i Republikës së Kosovës në Shqipërisë Sylejman Selimi, oficerë të KFOR-it, të FSK-së, atashe ushtarakë si dhe personalitete të tjera të jetës politike, artistike dhe kulturore.Në fjalën e tij, ministri Agim Çeku, pasi ka përshëndet mysafirët, falënderoi të gjithë ata që e kanë mbështet ngritjen e FSK-së, për të shtuar: "Është kënaqësi që jemi mbledhur sot këtu për ta fuqizua miqësinë dhe bashkëpunimin tonë, ta përcjellim së bashku këtë vit dhe të shikojmë me optimizëm drejt vitit të ardhshëm. Forca e Sigurisë së Kosovës është e përkushtuar të bëhet një forcë aktive dhe e dukshme, një institucion i përkryer i cili do t'i shërbejë të gjithë qytetarëve dhe po kontribuon në ndërtimin e paqes dhe stabilitet në rajon dhe në botë. Edhe këtë vit ne kemi punuar shumë dhe kemi arritur një progres të dukshëm në shumë fusha. Ne e kemi thelluar partneritetin tonë bilateral dhe i kemi nënshkruar disa Marrëveshje Bashkëpunimi me shtetet tona partnere, kemi marr pjesë në iniciativa dhe ngjarje të rëndësishme të lidhura me çështjet e sigurisë, e kemi themeluar Qendrën e Ekselencës për Kërkim-Shpëtim nga e cila do të përfitojë i gjithë Rajoni, kemi kaluar Ligjin e pensioneve për FSK-në, jemi pajisur me uniforma te reja unike moderne dhe funksionale". Ministri Çeku foli edhe për besimin e madh që ka FSK-ja tek qytetarët e Kosovës. " Për mua është shumë i rëndësishëm fakti që FSK-ja është ndër institucionet më të besuara të Kosovës. Kjo ka një domethënie të madhe dhe na inspiron që të punojmë edhe më shumë për të mirën e vendit dhe popullit tonë". Për kultivimin e vlerave artistike dhe kulturore në FSK-së, ministri Çeku, tha:" Ne jemi vazhdimisht duke i kultivuar vlerat dhe traditat tona, por edhe identitetin tonë. Si pjesë e kësaj përpjekje kemi themeluar Orkestrën Frymore të Forcës së Sigurisë së Kosovës një Orkestër i cili aktualisht është i përbërë nga më shumë se 30 muzikantë të rinj, profesionistë të profesioneve të ndryshme, qoftë pjesë e Filarmonisë, qoftë profesorë, arsimtarë, mësimdhënës të edukatës muzikore që vullnetarisht janë lajmëruar të jenë pjesëtarë edhe të FSK-së".

Në fund, ministri Agim Çeku ua uroj të gjithëve Krishtlindjet dhe një Vit të Ri dhe të suksesshëm dhe njëherit kërkoi që bashkërisht ta përcjellin koncertin e parë të ekzekutuar nga Orkestra Frymore e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pastaj, Orkestra Frymore e FSK-së, dha një koncert me vepra të famshme botërore dhe kombëtare. Këngët "Valsi i lumturisë, "Kënga për heroin e kombit tim", "Hej ju male", "Agimet Shqiptare", etj, ishin disa nga veprat artistike të interpretuara me sukses nga Orkestra Frymore e FSK-së. Interpretimi i këngëve ushtarake dhe klasikë, nën dirigjimin e Toger Baki Jasharit u përcoll me një interesim të madh dhe me duartrokitje të gjata e frenetike. Është synim i MFSK-së që Koncerti Festiv i Orkestrës Frymore të FSK-së, për çdo Vit të Ri, do të jetë tradicional.



FSK-ja në Paradën e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë

Në paradën e 100 vjetorit të krijimit të Shtetit Shqiptar për herë të parë mori pjesë edhe një kuadrant i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), në përbërje prej 65 pjesëtarëve, ku prej tyre 11 ishin femra. "Është një ndjesi shumë e mirë, është privilegj dhe nder të marrësh pjesë në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Për neve është një krenari shumë e madhe, mund të them krenaria më e madhe që unë kam përjetuar", është shprehur një prej anëtarëve të FSK-së. Kuadrati i FSK-së u tregua shumë i sukseshëm.

FSK-ja përfitoi donacion nga Zyra Civile Ndërkombëtare

Forca e Sigurisë së Kosovës ka përfituar një donacion nga Zyra Civile Ndërkombëtare-ICO, donacion ky i cili ka vlerë të çmueshme për nevoja të FSK-së dhe njësive të saj.

Ministri Agim Çeku e ka vlerësuar aktin e ICO-së me rastin e ndarjes së këtij donacioni për FSK-në, si edhe ka çmuar prioritetin e Zyrës Civile



Ndërkombëtare sipas së cilit, FSK-ja ka qenë përfituese e këtij donacioni. Ministri Çeku është shprehur se infrastruktura dhe pajisjet për FSK-në, në vazhdimësi janë përparësi, kështu që përkrahja me donacione është e mirëseardhur dhe shumë e nevojshme. Ai ka falënderuar Zyrën Civile Ndërkombëtare për mbështetjen që i ka dhënë FSK-në me rastin e ndarjes së donacionit. Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati ka vlerësuar lartë vlerën e donacionit e cila do të jetë në shërbim të Kompanisë së Deminimit Humanitar. Donacioni kap vlerën rreth 150 mijë euro, pajisje transporti. Gjithsej gjashtë automjete, prej tyre dy minibus dhe katër xhipa, si edhe pajisje të teknologjisë informative (pesëdhjetë kompjuterë).

FORCA JONË

* * * Viti II • Nr. 9 • shkurt 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, vizitoi SHBA-në

Mbështetje për Kosovën në Pentagon



Ministri i FSK-së z.Agim Çeku së bashku me komandantin e Komandës së Forcës Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Ramën, kanë qëndruar për një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku patën takime të shumta, në Pentagon, Uashington DC etj.

Më 29 janar, ministri Çeku u prit në Pentagon nga zëvendësshefi i Byrosë së Gardës Kombëtare; gjenerallejtënant Joseph Lengyel, gjeneralmajor Timothy Orr, z.Thomas Niblock, gjeneral brigade Daniel Lokanson dhe dr. John Finney. Po ashtu të pranishëm ishin edhe ambasadori i Kosovës në SHBA, Akan Ismaili, gjeneralmajor Rrahman Rama dhe gjeneral brigade Xhavit Gashi, atashe ushtarak.

Në takim u bisedua për bashkëpunimin e shkëlqyer në mes të Kosovës dhe Shtetit të Ajovës në Programin e Partneritetit Shtetëror (PPS), si dhe për mundësitë e thellimit të këtij bashkëpunimi. Gjithashtu delegacioni i FSK-së foli edhe për iniciativat rajonale të cilat po i ndërmerr përmes EMAC-së, Task-Forcës Rajonale për Kërkim-Shpëtim dhe për mundësitë e përfshirjes së shteteve të rajonit të cilat kanë PPS me shtetet përkatëse në SHBA.

Të dy palët shprehen gatishmërinë që bashkëpunimi të thellohet edhe në fusha tjera.

Ministri Çeku dhe delegacioni që ai kryeson, zhvilluan një takim edhe në Departamentin e Mbrojtjes në Pentagon, ku u pritën nga zëvendëssekretari i Mbrojtjes për Politika, dr. James Miller dhe zëvendës asistentja e Sekretarit të Mbrojtjes dr. Evelyn Farkas.

Ministri Çeku në këtë takim potencoi rëndësinë e të qenit partner strategjik me SHBA-të, sidomos në fushën e mbrojtjes. Gjithashtu ai foli për procesin e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë (RSSS) ku ministri e informoi dr. Millerin për rrjedhën dhe hapat e mëtutjeshëm të bashkëpunimit në të ardhmen.

Po ashtu ministri Çeku me bashkëpunëtorë, u pritën në State Departament nga zëvendësdrejtori i Zyrës për Çështje Evropiane David Burgeri dhe Mark Flemingi, nga Këshilli Kombëtar i Sigurisë. Gjatë këtij takimi u bisedua për arritjet e FSK-së, për procesin e RSSS-së, për proceset nëpër të cilat po kalon FSK-ja si dhe për të ardhmen e saj. Nga ana e State Dpartmentit u riafirmua mbështetja dhe të dy palët u pajtuan që procesi i rishikimit të RSSS të vazhdojë me koordinim të ngushtë me SHBA-të, të cilat e kanë dhe rolin udhëheqës në këtë proces.



Më 17 shkurt parakalon FSK-ja në kryeqytet

Në pesë vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 1013, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, do të parakalojnë kuadratet e FSK-së së bashku me Policinë e Kosovës dhe Agjencia për Emergjenca.

FSK-ja do të parakalojë me gjashtë kuadrate, Policia e Kosovës me katër kuadrate dhe Agjencia për Emergjenca me një kuadrat. Përveç ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve që do të jenë pjesë e paradës, kjo është hera e parë, që FSK-ja do të parakalojnë edhe me automjetet të rënda që disponon.

Ministri pritet edhe në qytetin Johnson të Ajovës

Gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministri i FSK-së Agim Çeku së bashku me gjeneralmajor Rrahman Ramën dhe atasheun ushtarak të SHBA-ve, në Prishtinë, kolonelin James Kottin, më 30 janar,vizituan

Kryetarja e qytetit Jahnston në shtetin e Ajovës, znj. Paula Dierenfeld dhe anëtarët e Këshillit të Qytetit e kanë prit me nderime delegacionin e Ministrisë së FSK-së në shenjë respekti ndaj Partneritetit Shtetëror në mes të Kosovës dhe Ajovës. Kryetarja Dierenfeld ka falënderuar ministrin Çeku për bashkëpunimin dhe kontributin e tij në krijimin e lidhjeve në mes të dy vendeve. Ndërsa, ministri Çeku pasi përshëndeti kryetaren dhe të pranishmit, foli për rëndësinë e Partneritetit Shtetëror, për zgjerimin e bashkëpunimit përtej atij tradicional, duke u thelluar, në: bujqësi, shëndetësi, arsim, kulturë etj.

Në fund të takimit kryetarja e Johnstonit, znj. Paula Dierenfeld i dhuroi ministrit Çeku, Proklamatën e shkruar, si dhuratë për 5-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, si shenjë respekti dhe nderi nga qyteti i saj Johnston. Ajo tha: "Ne kemi shumë të përbashkëta me njerëzit e Kosovës. Ata i duan familjet, arsimi është i rëndësishëm për ta, ekonomia e tyre bazohet në bujqësi, janë punëtorë dhe mbi të gjitha janë njerëz të ngrohtë dhe miqësorë, ashtu sikurse ne në Ajova.".

Senati i Ajovës e shpalli Agim Çekun "Qytetar Nderi"

Ministri i FSK-së Agim Çeku, gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka zhvilluar takime të shumta me personalitetet më të larta të SHBA-s, në Pentagon dhe në Shtetin e Ajovës. Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati i Shtetit të Ajovës, kanë organizuar pritje për Ministrin Çeku dhe gjeneral Rrahman Ramën. Ministri i FSK-së, Agim Çeku mbajti një fjalë në Senat,

ku foli për Partneritetin Shtetëror me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ai, pasi falënderoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën dhënë Kosovës, tha: "Unë do të doja të shfrytëzoja këtë mundësi dhe e ritheksoj që ne e vlerësojmë shumë mbështetjen që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë dhe vazhdojnë t'i japin për Kosovën. Kjo nuk është e pazakontë për njerëzit e Kosovës që valëvitin flamurin amerikan për të shprehur mirënjohjen e tyre dhe mirënjohja për të gjithë mbështetjen që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë për ta.

Programi i Partneritetit Shtetëror është një partneritet i vërtetë, një vepër e aftësisë gjeniale, dhe ne jemi shumë të kënaqur, që ta kemi Ajovën, si partnerin tonë shtetëror.

Programi i Partneritetit Shtetëror me Gardën Kombëtare të Ajovës ka qenë shumë i dobishëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës, meqenëse po i ndihmon për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme dhe të bëhet një forcë profesionale, e aftë dhe e dislokueshme, duke u shërbyer të gjithë qytetarëve të saj dhe duke kontribuar në sigurinë rajonale dhe globale.

Partneriteti është një marrëdhënie, dy mënyra. Ashtu si partnerët tuaj, unë dua të ju bëj me dije se në qoftë se Shtetet e Bashkuara dislokon (pozicionon) Gardën Kombëtare të Ajovës për operacionet jashtë shtetit, kjo është dëshira e Forcës së Sigurisë së Kosovës për tu bashkuar me ju, në mënyrë që të qëndrojë krah për krah me partnerët tanë. Ky është vullneti ynë i fortë për t'i ndihmuar dhe mbështetur nëse ata kanë nevojë dhe ta bëjmë këtë botë, më të mirë".

Në fund, senatori Darryl Beal e lexoi Proklamacionin e Senatit të Ajovës, me rastin e shpalljes së ministrit të FSK-së, Agim Çekut qytetar nderi, me motivacionin, për kontributin e tij në forcimin e lidhjeve në mes të Kosovës dhe Ajovës.



Ministri i FSK-së priti shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku, priti në një takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian(BE) në Kosovë, z. Samuel Zhbogar. Në takim mori pjesë edhe shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s(NAT) për FSK-në, z. Kevin Linç.

Ministri Çeku e informoi përfaqësuesin e Bashkimit Evropian z. Zhbogar, mbi zhvillimet në MFSK dhe FSK, për të arriturat, sfidat si edhe angazhimet rreth realizimit të synimeve dhe objektivave të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në të mirë të zhvillimeve në vend, rajon e më gjerë. Po ashtu, ministri Çeku e njoftoi shefin e BE-së për Kosovë për angazhimin e MFSK-së dhe të FSK-së për bashkëpunim me NATO-n, si edhe strukturat e Sigurisë së



Bashkimit Evropian. Gjithashtu ministri Çeku shprehu gatishmërinë për pjesëmarrje në misionet paqeruajtëse të sigurisë së Bashkimit Evropian. Ndërsa shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Samuel Zhbogar u interesua gjerësisht mbi të arriturat dhe planet e ministrit për të ardhmen e MFSK-së dhe FSK-së. Ai njëherësh premtoi angazhimin dhe mbështetjen e tij në iniciativa e Bashkimit Evropian.

Çeku takoi ambasadorin e Francës dhe të Anglisë

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK-së), Agim Çeku, priti në MFSK në një vizitë zyrtare ambasadoren e Francës në Kosovë Maryse Daviet.

Në këtë takim u bisedua për marrëdhëniet dypalëshe në mes Kosovës dhe Francës, si dhe për zhvillimin e Forcë së Sigurisë së Kosovës, me theks të veçantë u bisedua për ecurinë e procesit të Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë (RSSS), si dhe për mbështetjen dhe kontributin që mund të ofrojë Franca në këtë proces.

Kjo është vizita e parë zyrtare, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e ambasadores franceze që kur ajo është emëruar ambasadore në Kosovë.



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), Agim Çeku, i shoqëruar edhe nga shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK zoti Kevin Linç (Kevin Linch), priti në ambientet e MFSK-së për vizitë ambasadorin e Anglisë zotin Jan Klif (Ian Cliff).

Në takimin e zhvilluar në mes të ministrit Çeku dhe ambasadorit Klif u diskutua për ecurinë e procesit të Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë (RSSS), si dhe për mbështetjen dhe kontributin që Britania e Madhe mund të jap në zhvillimin e këtij procesi.



Ambasadori Klif ndër të tjera e informoi ministrin Çeku edhe për të arriturat e dy oficereve të FSK-së; nëntoger Mimoza Budeci dhe nëntoger Manushaqe Nura, të cilat gjenden në Akademinë Ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar në Sandhurst. Ai me këtë rast informoi ministrin Çeku se këto dy oficere janë ndër studentet më të suksesshme të kësaj akademie dhe njëra ndër to është shpallur studentja më e mirë.

Ambasadori Klif e ftoi ministrin Çeku, që me 9 gusht, të jetë prezent në ceremoninë e diplomimit të këtyre kadetëve të Akademisë Ushtarake në Sandhurst, me ç'rast ministri do të zhvillojë edhe takime dypalëshe me autoritetet e larta të Britanisë së Madhe.

Shkollim njëvjeçar në Akademinë Ushtarake është realizuar me ftesë formale nga Qeveria e Britanisë së Bashkuar, dhe kjo ka qenë hera e parë që Kosova ka dërguar dy kadetë-femra në Akademinë Ushtarake në Sandhurst.

Zëvendësministri Shemsi Veseli priti kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinajn

Zëvendësministri i FSK-së, Shemsi Veseli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati pritën për vizitë në MFSK, kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotëri Ramush Haradinajn me bashkëpunëtorë. Në takim morën pjesë edhe zëvendësministri Bejtush Gashi dhe gjeneralmajor Zymer Halimi.

Zëvendësministri Veseli pasi i uroi mirëseardhje zotit Haradinaj, e njoftoi edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, kapacitetet aktuale dhe me objektivat e saj në zhvillim.

Ndërsa komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, e njoftoi kryetarin e AAK-së për zhvillimin e FSK-së, plotësimin e kapaciteteve operacionale, formimin e Task Forcës për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës (RSSSK), pastaj për pjesëmarrjen në Nismat Regjionale A-5, për bashkëpunimin ndërkombëtar, për partneritetin me SHBA-t etj.

Kryetari i AAK-së Ramush Haradinaj përgëzoi stafin e MFSK-së dhe FSK-së për të arriturat e deritashme dhe për ndryshimet pozitive, të cilat sipas tij janë mjaft inkurajuese. Ai ndër të tjera e vlerësoi FSK-në si një tregim suksesi. Po ashtu kryetari Haredinaj e vlerësoi lartë punën dhe dinamikën që po ndjek FSK-ja në zhvillimin e vet për tu bërë forcë profesionale dhe e aftë edhe për misione jashtë vendit.



Ambasadori i Shqipërisë në NATO, Artur Kuko, vizitoi FSK-në

Zëvendësministri i FSK-së Shemsi Veseli së bashku me Bejtush Gashin, zv. ministër, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe shefi i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar nënkolonel Hasan Hoxha dhe, kanë pritë, në ambientet e Ministrië, ambasadorin e Shqipërisë në NAT, z. Artur Kuko i cili shoqërohej nga Spiro Koci ambasador në OSBE, Islam Lauka ambasador në Kosovë dhe Ilir Melo drejtor i Përgjithshëm.

Në takim u diskutua për të arriturat e FSK-së, perspektiven e përfshirjes së saj në operacionet paqeruajtëse në fushat ku FSK ka arritur Kapacitetet e Plota Operacionale dhe ka dëshmuar profesionalizëm të lartë. Me theks të veçantë u diskutua për zhvillimin e bashkëpunimit me NATO-n dhe për pjesëmarrje në nismat regjionale të sigurisë. Po ashtu u bisedua për zhvillimin e procesit të Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës (RSSSK), ku parashihet edhe struktura e ardhshme e FSK-së. Diplomatët nga Shqipëria vlerësuan lartë arritjet e FSK-së dhe premtuan angazhimin në prezantimin e suksesëve të FSK-së tek vendet anëtare të Aleancës Veri-Atlantike.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati takohet me komandantin e Ushtrisë së SHBA-së për Evropë



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i shoqëruar nga gjeneral brigade Bashkim Jashari, gjeneral brigade Zymer Halimi dhe major Fadil Hoxha, ka pritur në takim komandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropë (USAREUR), gjenerallejtënant Donald M. Campbell, i shoqëruar nga oficerë të lartë si dhe nënkolonel Emily Thomas - atashe ushtarak në Ambasadën amerikane në Prishtinë.

Komandant Kastrati ka njoftuar kolegun nga Ushtria e SHBA-ve me zhvillimet në MFSK dhe FSK, duke shpjeguar misionin dhe strukturën e FSK-së, arritjet e deritashme, sfidat, objektivat për vitin 2013 dhe pajisjet dhe nevojat e FSK-së për zhvillim të mëtejmë.

Me këtë rast komandanti Kastrati falënderoi Ushtrinë e SHBA-ve për ndihmën që po u jep, si në fushën e trajnimeve ashtu edhe të donacioneve, stafit të oficerëve që janë në FSK dhe në Ekipin NATO-s. Ai vlerësoi lart bashkëpunimin e mirë me atasheun ushtarak në Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë. Me theks të veçantë komandant Kastrati foli për bashkëpunimin e mirë dhe intensiv me Gardën Kombëtare të Ajovës, për këmbimin e delegacioneve, si dhe për mbështetjen në fushën e trajnimeve me interes për FSK-në. Po ashtu, ai, foli edhe mbi rëndësinë e Rishikimit të Sektorit Strategjik Këshillues të vlerësoi lart të Sigurisë në Kosovë gjatë këtij viti ku do të përcaktohet edhe struktura e ardhshme e FSK-së.



Komandanti i Ushtrisë së SHBA-ve për Evropë, gjenerallejtënant Donald M. Campbell, duke shprehur kënaqësinë për arritjet e FSK-së dhe shkallën e profesionalizmit që ka arritur, me nivelin e mirë të bashkëpunimit mes ushtrisë së SHBA-ve dhe FSK-së, u zotua që ky bashkëpunim të jetë edhe më intensiv në fushat që janë me prioritet për FSK-në.

Një delegacion i lartë i Ushtrisë së Turqisë qëndroi për vizitë pune në FSK

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati i shoqëruar nga zëvendësministri i FSK-së Bejtush Gashi, gjeneral brigade Zymer Halimi, kolonel Ilir Qeriqi dhe major Fadil Hoxha, priti në një vizitë pune një delegacion të ushtarakëve të lartë nga Turqia. Delegacionin turk e kryesonte anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Turqisë, gjenerallejtënant Metin IYIDIL, i shoqëruar nga Komandanti i Xhandarmërisë Ibrahim AYDIN, kolonel Aygun Eker komandant i kontingjentit turk të KFOR-it dhe ushtarakë të tjerë.

Zëvendësministri Bejtush Gashi, në fillim, falënderoi ministrin e Mbrojtjes së Turqisë dhe shtetin e Turqisë për bashkëpunimin dhe përkrahjen që po jep në ngritjen, trajnimin dhe donacionet e çmuara për FSK-në, në kuadër të bashkëpunimit të gjerë mes dy ministrive dhe dy shteteve mike.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati i njoftoi gjeneralët nga Turqia me zhvillimet aktuale në FSK, me objektivat e arritura për vitin 2012 dhe me sfidat që e presin FSK-në në vitin 2013. Me theks të veçantë ai foli për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë dhe diskutimet që po zhvillon Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me NATO-n dhe me partnerët tjerë strategjik për strukturën e ardhme të FSK-së. Po ashtu gjeneral Kastrati falënderoi kolegët



nga Turqia për ndihmën e madhe që po jep ushtria turke në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit intensiv, sidomos në fushën e trajnimeve dhe donacioneve që po i jep shteti turk për ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së.

Në takim u shqyrtuan edhe mundësitë e thellimit të këtij bashkëpunimi në fushat me interes dhe me prioritet të FSK-së.

Gjenerali nga Turqia, Metin IYIDIL duke shprehur falënderimet për mikpritjen dhe duke përgëzuar FSK-në për shkallën e arritjeve të deritashme, shprehu gatishmërinë e Ushtrisë së Turqisë që edhe në të ardhmen të përkrah FSK-në në fushat me përparësi dhe interes. Bashkëpunim ky i bazuar në marrëveshjen e nënshkruar në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë dhe Ministrisë së FSK-së, si dhe marrëdhënieve shumë të mira që ekzistojnë në mes të dy vendeve.

Komandanti i FSK-së, pjesëmarrës në ceremoninë e Ushtrisë amerikane për Evropë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me ftesë të Ushtrisë Amerikane për Evropë mori pjesë në ceremoninë e ndërrimit të komandës së kësaj ushtrie, e cila u mbajt në Wiesbaden të Gjermanisë.

Komandanti i ri në detyrë i Ushtrisë së SHBA-ve në Evropë, gjeneral Donald M.Campbell priti në takim komandantin e FSK-së, gjeneral Kadri Kastratin. Në takimin e të dy gjeneralëve u bisedua për mundësitë dhe mënyrat e bashkëpunimit në fusha të caktuara në mes të USAREUR-t dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në ceremoninë e ndërrimit të komandës morën pjesë KOMFSK, gjenerallejtënant Kadri Kastrati i shoqëruar nga toger Fatmir Demiri, si dhe komandantët e Forcave Tokësore të Shqipërisë, Bullgarisë, Lituanisë, Polonisë dhe Rumanisë, po ashtu edhe shumë personalitete të shquara të jetës politike dhe ushtarake në Evropë, përfshirë edhe admiralin James Stavridis, komandant i Forcave të SHBA-ve për Evropë.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe gjenerali amerikan Michael Bills biseduan për zhvillimet në FSK

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në ambientet e Ministrisë për FSK-në priti në vizitë zyrtare një delegacion oficerësh të lartë të Ushtrisë Amerikane për Evropë të prirë nga gjenerali i G-3 Michael Bills (US Army Europe). Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, e njoftoi gjeneralin Bills për zhvillimet dhe të arriturat e FSK-së, si dhe për bashkëpunimin dypalësh në mes të SHBA-ve dhe Kosovës. Ndërsa, gjenerali amerikan, Michael Bills e njoftoi komandantin e FSK-së për të arriturat



e Ushtrisë Amerikane në Evropë dhe për bashkëpunimin e mëtutjeshëm me Forcën e Sigurisë së Kosovës.

FSK-ja mban ligjërata për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i minave

Forca e Sigurisë së Kosovës e filloi sezonin dimëror me mbajtjen e ligjëratave për vetëdijesimin e nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera, nëpër shkollat fillore në territorin e Kosovës. Ligjëratat po mbahen nga instruktorët e FSK-së.

Rreshter major Isa Palushi përgjegjës i këtyre instruktorëve tha: "Janë 12 instruktorë të FSK-së, të cilët janë trajnuar dhe licencuar për mbajtjen e ligjëratave. Ata janë të përgatitur dhe këtë punë po e bëjnë më shumë përkushtim dhe përgjegjësi. Në agjendën e ditës së sotme, 23 janar 2013, ligjëratat u zhvilluan në shkollën e Harilaqit dhe të Sllatinës, ku pjesëmarrës ishin të gjithë nxënësit e cikleve të ulëta të këtyre shkollave. Ata janë shumë të interesuar për rritjen e njohurive për sa i përket mjeteve të pashpërthyera dhe çdo herë e më shumë po tregojnë interesim për zgjerimin e njohurive rreth tyre".

Ndërkaq Hamit Sopjani, përgjegjësi i shkollës fillore "Bajram Curri" shprehu mirënjohjen e tij për kontributin që po ofron FSK-ja për ndërgjegjësimin e nxënësve me anën e këtyre ligjëratave, ai njëherësh i cilësoi ligjëratat më të vlefshme se çdo gjë tjetër, sepse përmes tyre tha ai fëmijët tanë po mësojnë se çka konkretisht janë mjetet e rrezikshme dhe se si ata në të ardhmen me njohuritë e fituara në këto ligjërata mund të kontribuojnë që të shpëtojnë një jetë. Instruktorët e FSK-së përmes shenjave të rrezikut dhe fotografive të mjeteve të pashpërthyera po ua sqarojnë fëmijëve në përpikëri rrezikun që ju kanoset çdo ditë.





Dren Berisha nxënës i klasës së VIII, tha se FSK-ja u ofrojë atyre shumë informacione që nuk i kishin ditur më parë "Nga këto ligjërata ne mësuam më hollësisht se sa të rrezikshme janë këto mjete, si duhet të jemi të kujdesshëm në raport me to dhe si të sillemi në rast kur i hasim ato".

Po aq e entuziazmuar për mësimet që i kishte marrë nga ky ligjërim ishte edhe nxënësja e klasës së VII Albiona Kolshi, e cila më shumë emocion tregoi edhe historinë e një djaloshi të ri i cili si pasojë e shkeljes në mjete të pashpërthyera kishte humbur jetën. Andaj thotë ajo këto njohuri që ne morëm sigurisht do të na ndihmojnë shumë që të mos përsëritën më këso histori të dhimbshme.

Ligjërimi i instruktorëve të FSK-së për vetëdijesimin nga minat ka filluar më 21 janar dhe do të përfundojë më 21 shkurt 2013. Kjo fushatë vetëdijesimi bëhet në bashkëpunim të MFSK -së, MASHT-it dhe Drejtorive Komunale të Arsimit.

Që nga paslufta e fundit në Kosovë 115 persona kanë humbur jetën si pasojë e shkeljes në mjetet e pashpërthyera; 452 persona janë lënduar; janë gjetur 1300 mjete të pashpërthyera; FSK-ja ka pastruar sipërfaqen prej 160 mijë metër katror, 54 fusha janë ende të rrezikshme, prej tyre 41 me bomba kasetë dhe 13 fusha të minuara.

Konferencë rajonale 'Zhvillimi i nënoficerëve dhe bashkëpunimi ndërajonal'

Me organizim të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nga data 14-16 janar, në Prishtinë, zhvilloi punimet Konferenca rajonale e nënoficerëve të ushtrive të vendeve të rajonit me temë "Zhvillimi i nënoficerëve dhe bashkëpunimi ndërkombëtar".

Në konferencë morën pjesë nënoficerë të ushtrive të vendeve të rajonit dhe nënoficerë të Komandës Amerikane për Evropë, si edhe të Ushtrisë gjermane.

Në hapjen e punimeve të konferencës një fjalë rasti e mbajti komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili u shpreh se ndjehet tejet i lumtur që FSK-ja ka arritur këtë nivel që të bashkojë nënoficerët e shumicës së ushtrive të vendeve të rajonit.

Gjeneral Kastrati, gjithashtu, konfirmoi mbështetjen e plotë të tij në zhvillimin dhe profesionalizimin e Trupës së nënoficerëve.

Komandanti Kastrati theksoi edhe rëndësinë e bashkëpunimit të nënoficerëve të ushtrive të vendeve të rajonit, si edhe mbështetjen që kjo kategori po merr nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë(EUCOM).

Rreshter majori i parë i Komandës së Forcave Tokësore Fetah Zejnullahu, në emër të organizatorit u shpreh i lumtur me gatishmërinë e ushtrive të rajonit për të marrë pjesë dhe për t'i kontribuar planifikimit për zhvillimin e Strategjisë së Zhvillimit të Nënoficerëve.

Ndër ligjëruesit e parë ishte rreshter majori i parë i Komandës Amerikane për Evropë, Roy Maddocks i cili prezantoi temën "Strategjia për sigurinë aktiveqasje regjionale". Në konferencë ishin të pranishëm nënoficerë nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, nënoficer të ushtrive të rajonit si nga: Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia, Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë.

Në mbyllje të punimeve të konferencës së nënoficerëve morën pjesë edhe ministri i FSK-së Agim Çeku dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneralmajor Rrahman Rama, të cilët në fund të punimeve të konferencës ndanë certifikata për pjesëmarrësit.

Qëllimi i kësaj konference ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të FSK-së me ushtritë e rajonit, si dhe mënyra e zbatimit të tyre në ushtritë përkatëse. Në prezantimet e të gjitha vendeve edukimi dhe trajnimi i pjesëtarëve si dhe puna e tyre me trupat ishte prioritet i ligjërimeve dhe angazhimeve në formë debati gjatë punimeve të konferencës.



Nënoficerët e FSK-së së bashku me ata të rajonit vizituan edhe njësinë e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në Ferizaj, ku patën mundësi të shohin punën e kësaj komande si dhe të njoftohen me trajnimet që zhvillohen atje, duke filluar nga trajnimi bazik e deri tek trajnimet e specializuara.

Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneralmajor Rrahman Rama, u shpreh i kënaqur me rezultatet e konferencës si dhe i falënderoi ata për pjesëmarrje, duke shprehur gatishmërinë edhe për bashkëpunime tjera të ndërsjella në mes të FSK-së dhe ushtrive tjera.

Pjesëmarrësit e kësaj konference u shprehen të nderuar dhe shumë optimist për të arriturat e FSK-së, si dhe për vullnetin dhe gatishmërinë e kësaj Force për të punuar akoma më shumë.

Konferenca rajonale e nënoficerëve e organizuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës është e para e këtij lloji, në nivel të tillë, në rajon.

Takime, trajnime dhe operacione të përbashkëta planifikohen të zhvillohen edhe në të ardhmen më vendet e rajonit, gjithmonë në kuadër të planeve dypalëshe të bashkëpunimit.

Zyra për Komunitete dhe Barazi Gjinore prezantoi dokumentin 'Përmirësimi i bilancit gjinor dhe i komuniteteve'



Zyra për Komunitete dhe Barazi Gjinore në kuadër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 16 janar 2013, në Komandën e Forcave Tokësore (KFT) prezantoi dokumentin për Përmirësimin e bilancit gjinor dhe të komuniteteve.

Qëllimi i këtij prezantimi ishte "Praktikat më të mira dhe sugjerimet për integrimin e femrave dhe komuniteteve në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës".

Hapjen e këtij takimi e bëri ministri i FSK-së Agim Çeku, i cili para të pranishmeve përmendi të arriturat e MFSK-së dhe FSK-së në angazhimin për integrimin e femrave dhe rolin e tyre në FSK, si dhe integrimi i komuniteteve në këtë Forcë. Ministri Çeku, po ashtu, përmendi edhe ndërtimin e strukturave organizative në MFSK duke iu referuar Zyrës për Komunitete, Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrës për Barazi Gjinore.

"FSK-ja është një institucion i disiplinuar, profesional dhe i respektuar nga të gjithë qytetarët e Kosovës. Krenohemi që në vitin 2012 FSK-ja u shpall institucioni më i besueshëm në Kosovë, dhe është nderë dhe obligim që qytetarët e Kosovës na shohin si institucion model në vend" tha ministri i FSK-së Agim Çeku.

Ministri Çeku përmendi edhe disa nga të arriturat e femrave ushtarake dhe civile në FSK . Gjithashtu, ai përmendi pjesëmarrjen e dy oficereve të reja të FSK-së, të cilat po vazhdojnë shkollimin për kadet në Britani të Madhe, nëntoger Mimoza Budeci që është shpall kadeti më e suksesshme në shkollë dhe Manushaqe Nura që gjendet e dyta në listë.

Shefja e Zyrës për Çështje të Komuniteteve në MFSK dhe udhëheqja e Grupit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore Azemina Çullum, ofrojë të dhëna të sakta lidhur më praktikat e nxjerra gjatë punës me grupin punues në MFSK dhe FSK. Ajo tha se nuk është në pyetje vetëm rritja e përqindjes së femrave në këtë institucion, por edhe rritja e balancimit gjinor në të gjitha aspektet vendimmarrëse duke filluar nga edukimi, ngritja në karrierë etj, duke i përfshirë edhe komunitete dhe integrimin e tyre në këto struktura vendimmarrëse. "Për të ardhmen është shumë e rëndësishme që të thellohet bashkëpunimi në mes të FSK-së dhe shoqërisë civile" tha Azemina.

Para të pranishmëve foli përfaqësuesja e UN WOMEN Flora Macula, e cila tha se FSK-ja ka bërë punë të shkëlqyeshme në inkuadrimin e femrave në këtë institucion dhe asnjëherë nuk ka munguar mbështetja e Ministrisë në këtë drejtim. Ndërsa, udhëheqja e Rrjetit të grave, Igballe Rugova vlerësoi bashkëpunimin në mes të shoqërisë civile dhe FSK-së, duke shtuar se në bazë të këtij bashkëpunimi dhe mundësive për shkëmbimin e ideve tona tregon që Ministria e FSK-së është e gatshme për zbatimin e konventave ndërkombëtare.

Në hartimin e dokumentit për Përmirësimin e bilancit gjinor dhe të komuniteteve, përveç MFSK-së dhe FSK-së kontribut kanë dhënë ekipi i NATO-s, përfaqësues nga Policia e Kosovës, Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, UN WOMEN dhe Rrjeti për Zbatimin e Politikës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MFSK.

Pjesëmarrës në këtë organizim ishin ministri i FSK-së Agim Çeku, zëvendësministrat Bejtush Gashi dhe Sllavisha Filipoviqi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFT-së gjeneralmajor Rrahman Rama, atasheu ushtark James Skotti, Igballe Rugova- përfaqësuese nga Rrjeti i grave, Flora Macula- përfaqësuese e UN WOMEN, përfaqësues tjerë të shoqërisë civile si dhe ushtarak të NATO-s në Kosovë.



Komandanti i FSK-së Kadri Kastrati nderoi heroin e kombit Zahir Pajazitin

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kardi Kastrati me rastin e 16 -vjetorit të rënies heroike të heroit të kombit Zahir Pajaziti bëri homazhe pranë shtatores së tij. Së bashku me komandantin bënë homazhe edhe dy zëvendësministrat e FSK-së Shemsi Veseli dhe Bejtush Gashi, si dhe oficerë të lartë të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK-së) dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Intervistë me këshilltarin e NAT-it, nënkolonel Stefan Ceder

BCU-ja e gatshme për ta kryer misionin e vet edhe në operacione



Si këshilltar i Ekipit të NATO-s, gjithmonë kam qenë në dispozicion për të diskutuar dhe këshilluar për interesa më të mira për Ministrinë dhe FSK-në. Çështjet kryesore për një këshilltar janë: qeverisja, transparenca, mbikëqyrja demokratike dhe civile.

Gjatë kohës sime, këtu në Ministrinë e FSK-së, kam qenë këshilltar i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, për Njësinë e të Drejtave të Njeriut dhe për Departamentin e BCU-së, kam këshilluar tema të ndryshme dhe shumë të rëndësishme që kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt me këto departamente. Në Departamentin e BCU-së, kam ndihmuar me këshilla e mia në standardizimin e dokumenteve të BCU-së, siç janë: Politika e BCU-së, Doktrina e BCU-s, Manuali (TTP-i) të gjitha me standarde të NATO-s, përgatitja e prezantimit të projekteve përmes hartave etj. Gjatë kësaj kohe sa kam qenë këshilltar në BCU, kamë mbështet kryesisht realizimin e projekteve të vogla të BCU-së, në mënyrë që të ngrisim imazhin e FSK-së për të gjithë qytetarët e Kosovë, kam ndihmuar në qasjen profesionale gjatë intervenimit në fatkeqësinë natyrore në Restelicë, në përpilimin e kërkesave standarde, gjithashtu kam ndihmuar grupet punuese të BCU-së në organizimin e takimit tremujor të BCU-së.

Jam shumë i kënaqur sidomos me angazhimin profesional të drejtuesve të BCU-së dhe pjesëtarëve të FSK, në Restelicë, Junik, Zhilivodë dhe në shumë projekte tjera.

Të gjitha këto veprime janë kryer në bazë të një bashkërendimi të ngushtë në mes Departamentit të BCU-së në Ministrinë e FSK-së dhe Departamentit të BCU-s në Komandën e Forcave Tokësore.

Gjithmonë jam munduar t'i shfrytëzojë përvojat e mia, gjatë misionit tim në MFSK, dhe për këtë jam shumë i kënaqur me punën dhe profesionalizimin e të gjithë pjesëtarëve që punojnë këtu sipas këtyre përvojave.

Themelimi i një rrjeti produktiv është një nga faktorët e rëndësishëm për të pasur suksese, në punën e BCU-së, dhe nganjëherë një kafe ose edhe një raki së bashku me një të qeshur, janë derë e hapur e bashkëpunimit dhe realizmit të synimeve të BCU-së.

Këtu në Kosovë keni përdorur BCU-në si një fjalë për të mbuluar të gjitha aspektet e bashkëpunimit civil-ushtarak, por në NATO është përdorur vetëm në operacione. Emërimi im formal ka qenë këshilltar për Marrëdhëniet Civile-Ushtarake dhe arsyeja për këtë është pikërisht që kam provuar për të mbuluar jo vetëm bashkëpunimin civil-ushtarak, por edhe asistencën humanitare në mbështetje të shoqërisë së Kosovës dhe planifikimin e emergjencave civile.

Jam shumë i kënaqur me frytet e arritura në përparimin e marrëdhënieve civile-ushtarake si në Departamentin BCU-së në MFSK, ashtu edhe në Komandën e Forcave Tokësore.

Përdorimi i standardeve të NATO-s, i standardeve të OKB-s dhe të BE-s, janë shumë të rëndësishme për BCU-në, për rritjen e ndërveprimit dhe profesionalizmit në të ardhmen.

Sigurisht që ka shumë më shumë për t'u bërë, por ju duhet ta mbani mend se MFSK-ja dhe FSK-ja është vetëm katër (4) vjeçare; "një fëmijë shumë aktiv me shumë energji që ka nevojë për t'u këshilluar në mënyrë që të jetë krenar, përgjegjës, i respektueshëm dhe plotë nderim në Evropë!"

Unë kam ndjenja të përziera tani, kur unë jam duke e lënë MFSK-në. Kam bërë shumë miq të mirë këtu në Kosovë dhe veçanërisht në Ministri dhe do të më mungoni të gjithë. Por, sigurisht jam shumë i lumtur që do të kthehem tek familja ime në Suedi.

Në fund, ndjehuni krenar për gjithë punën e mirë që keni bërë në Ministri. Respektoni njëritjetrin, pa marrë parasysh kombësinë apo gjininë.

Gjithë të mirat për Kosovën!



Përfundoi trajnimi njëjavor me temë "Prokurimi dhe kontraktimi"

Me organizim të Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes, në Ambasadën Amerikane u mbajt trajnimi njëjavor prej 14-18 janar 2013, me temë "Prokurimi dhe Kontraktimi", në hotel "Emerald", në Prishtinë me instruktorë nga Shkolla e Studimeve Pasuniversitare e Marinës së SHBA-ve në Monterey.

Objektivi i këtij trajnimi ishte kuptimi i parimeve themelore kontraktuese dhe përdorimi i tyre në fushën e prokurimit kompleks dhe jo kompleks. Theksi ka qenë i vendosur në sfidat lidhur me aktivitete kombëtare dhe ato globale të prokurimit. Kursi ka pasur për qëllim zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të prokurimit, zhvillimin e kërkesave, dokumenteve specifike teknike, të kushteve për oferta një dhe shumë burimore, si dhe monitorimin e kontratave.

Në ditën e fundit të këtij trajnimi ishte prezent edhe sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovë, Shkëlzen Syla së bashku më atasheun e Mbrojtjes kolonelin James Kotti, të cilët bënë shpërndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit e trajnimit. Me këtë rast sekretari Syla falënderoi Ambasadën amerikane për bashkëpunim.

Pjesëmarrës të trajnimit përveç përfaqësuesve të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe FSK-së ishin edhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Doganat, Policia e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit etj .

Intervistë me ushtarin e komunitetit boshnjak Edin Skokoviq të BRSH-së, në Mitrovicë

“Marrëdhëniet në mes të komuniteteve janë të shkëlqyeshme”

Gjatë vizitës që i bëmë Batalionit të Tretë të BRSH-së në Mitrovicë, na thanë se njëri nga ata që dallohet me punën dhe aktivitetin e tij është edhe Edin Skokoviq me përkatësi boshnjake. Ne shfrytëzuam rastin dhe bëmë një bisedë me ushtarin Skokoviq, ku u njoftuam me të arriturat dhe punën që ai kryen në këtë Batalion. Edin Skokoviq, vepron në Kompaninë A3, në Batalionin e Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së në Mitrovicë. Ai ka kryer shkollën fillor dhe të mesëm në Mitrovicë, ndërsa tani i vazhdon studimet në vitin e dytë në Fakultetin e Gjeologjisë. Në Forcën e Sigurisë së Kosovës është pranuar në Gjeneratën e Pare, gjatë vitit 2010, dhe kryen detyrat e ushtarit. Edini ka kryer trajnime të shumta në FSK-së, si në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, ku me angazhimin e tij është dalluar për të arriturat e tij në përvetësimin e mësimeve profesionale. "Unë me përkatësi jam boshnjak, por këtu nuk ka dallime, marrëdhëniet në mes të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve që punojnë këtu janë të shkëlqyeshme. Të gjithë veprojmë së bashku dhe pa dallim feje, race dhe komuniteti.

Asnjëherë nuk kam pasur probleme të kësaj natyre dhe për këtë jam shumë i kënaqur dhe i falënderoj të gjithë që më kanë pritur mirë dhe më kanë ndihmuar sa herë që kam pasur nevojë. Kushtet këtu janë shumë të mira dhe të volitshme për punë, për trajnime dhe për aktivitete të tjera. Momentalisht jemi duke zhvilluar trajnime të reja, të cilat i kemi ushtruar praktikisht në ambientet e kazermës sonë. Ushtrimet e këtij lloji, zakonisht, i kryejmë me instruktorët tanë dhe të KFOR-it turk."

Në fund, Edin Skokoviqi u shpreh më se i lumtur se marrëdhëniet në mes të komuniteteve që veprojnë janë shembull i mirë dhe se FSK-ja po ecën me hapa të sigurt drejt profesionalizmit të saj.



Kapiten Muzafer Selimi (oficer), pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës

“Motivi dhe suksesi, pjesëtarët e kompanisë sime”

Kapiten Muzafer Selimi nga Vernica e Mitrovicës është baba i tre fëmijëve (dy djem dhe një vajzë), është oficer në Forcën e Sigurisë së Kosovës, më konkretisht komandant i Kompanisë A3 në Batalionin e Tretë, në Brigadën e Reagimit të Shpejt në Mitrovicë. Është përgjegjës i angazhimit taktik, trajnimit, administrimit, menaxhimit të personelit, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së forcës dhe logjistikës së kompanisë si dhe detyrave shtesë që i caktohen nga komandanti i batalionit. Ai është komandant i 99 pjesëtarëve të FSK-së të cilët sipas tij janë një motiv i mirë për punë dhe suksese të vazhdueshme të kompanisë së tij. Fillimisht ai ka qenë oficer për Operacione dhe Plane në Qendrën Operative të këtij batalioni, kurse pas sukseseve të treguara në këtë sektor ai ngritët në detyrë dhe emërohet komandant kompanie. Kapiten Selimi ka



qenë edhe pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për të ajo periudhë është më e rëndësishmja në jetën e tij prej ushtaraku. "Gjatë viteve 98-99 kam qenë ushtar i Njësisë Speciale të UÇK-së në Zonën Operative të Shalës dhe për mua kjo kohë ka qenë dhe mbetet kujtim që nuk do të shlyhet kurrë" tha Selimi. Përveç periudhës së luftës sfidë tjetër për kapiten Selimin ishte edhe transformimi i pjesëtarëve në Forcën e Sigurisë së Kosovë ku shumë nga bashkëluftëtarët kishin mbetur jashtë kësaj force. Arsyen pse kishte vendosur të bënte jetën e një ushtaraku kapiten Selimi e tregon me krenari "Dëshira e madhe ndaj atdheut për çlirimin e vendit për të cilin shumë bashkëluftëtar, vëllezër e motra dhanë më të shtrenjtën e tyre, kjo ka qenë dhe vazhdon te jetë motivacioni im. Gjaku i tyre është vullnet dhe forcë që edhe sot më shumë përgjegjësi ta kryej punën e oficerit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Edhe po t'i ofrohej ndonjë mundësi tjetër Muzafer Selimi asnjëherë nuk do ta ndërronte profesionin e tij."Për asnjë arsye nuk do ta ndërroja profesionin tim prej ushtaraku, sepse ka 14 vite që unë e bartë këtë uniformë që më është bërë pjesë e përditshmërisë sime, dhe vetëm si oficer i forcës unë mund t'i kontribuoj vendit duke realizuar misionin që kërkohet nga ne" u shpreh Kapiten Selimi. Relacionet e tij më pjesëtarët e Kompanisë A 3 të Batalionit të Tretë janë jashtëzakonisht të mira. Ky sukses është arritur fal punës së palodhshme dhe respektimit të zinxhirit komandues që vepron në këtë kompani. "Marrëdhëniet në mes të stafit komandues dhe pjesëtarëve të kompanisë sonë janë shuam të mira duke u bazuar në punën dhe profesionalizmin që këta pjesëtarë e tregojnë çdo ditë. Çelës i suksesit të kompanisë sonë është përgatitja profesionale, fizike dhe psikike e pjesëtarëve të kompanisë, si dhe disiplina dhe dukja e tyre personale. Përveç si komandant kompanie ai ka kryer edhe shumë trajnime si: "Trajnimin për oficer", "Kursin themelor të oficerit shtabor", në Akademinë Ushtarake në Tiranë, trajnim me KFOR-in amerikan "Kursi i udhëheqësit (lidershipit) për njësi të vogla, trajnime në Çeki, si dhe trajnime të ndryshme brenda njësisë. Po ashtu ai është në përfundim të Fakultetit Juridik.

Rreshter Rifadije Ramadani (nënoficer), pjesëtare e Forcës së Sigurisë së Kosovës

“Jam me fat që jam pjesë e ushtrisë së ardhshme të Kosovës”

Rreshter Rifadije Ramadani është infermiere në Ekipin e Mjekësisë, në Batalionin e Tretë, në Brigadën e Reagimit të Shpejt, në Mitrovicë. Para se të flas për punën qe e bën aktualisht, Rifadija kujton kohën e luftës, atëherë kur ishte nxënëse e shkollës së mesme dhe kishte vendosur t'i bashkohej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si infermiere, në Zonën e Parë në Spitalin e Likovcit të Komunës së Skenderajt. " E kam parë të nevojshme që me profesionin tim prej infermiereje t'iu kontribuoi aq sa kam mundësi bashkëluftëtarëve dhe popullit tim" tha Ramadani. Ajo po ashtu ishte pjesë edhe e Trupave Mbrojtëse të Kosovës në po të njëjtën detyrë. Për Rifadijen kalimi nga TMK-ja në FSK ishte mjaft sfidues, për faktin që shumica e bashkëluftëtarëve të saj nuk kishin arritur që të bëheshin pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe kjo për të padyshim që ishte një goditje. Rreshter Ramadani e cilëson veten si vajzë me fat që i takon edhe FSK-së."Kam nderin që kam qenë pjesë e luftës dhe që vazhdoj ta mbaj uniformën e FSK-së dhe të jem vazhdimësi e gjeneratave të cilat dhanë shumë për këtë ditë në të cilën jetojmë sot, si dhe për këtë uniformë që në të ardhmen do të jetë simbol i ushtrisë dhe krenarisë së Kosovës" shtoi Rifadije Ramadani. Për rreshteren e FSK-së detyra e saj është gjithmonë sfiduese sepse çdo herë ka të bëjë me shëndetin e pjesëtarëve të FSK-së, por ajo më shumë emocion kujton kohën kur këtë detyrë e bënte gjatë luftës së viteve 98 dhe 99." Detyrën që më është caktuar e bëj me shumë dëshirë dhe përgjegjësi, por në krahasim me periudhën e UÇK-së tashmë puna është shumë më e lehtë dhe më e përballueshme. Atëherë sigurisht që na mungonin kushtet për punë, por vullneti dhe dëshira për t' i ndihmuar bashkëluftëtarët tanë të cilët edhe pse vinin me gjymtyrë të humbura për asnjë moment nuk e ndalnin këngën e cila u jepte atyre dhe neve forcë për të vazhduar tutje". Me këtë kujtim përfundon bisedën e saj pjesëtarja e Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejt në Mitrovicë. Rifadija ka përfunduar disa trajnime profesionale dhe të specializuara si : "Trajnime të ndihmës së parë", "Kursi për kompjuter", "Kursi për gjuhë angleze", "Qitje me armë" etj. Ajo ka të kryer



shkollën e mesme të mjekësisë dhe tani është në përfundim të Shkencave Politike dhe Administratë Publike, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Major Claire WOHLSCHAK: Përfitojnë të gjithë pjesëtarët e FSK-së

Si pjesë e projektit për bashkëpunim të shtuar ndërmjet KFOR-it dhe FSK-së, këshilltari për Çështje Gjinore i KFOR-it ofron trajnime për FSK-në, si ta integrojmë perspektivën gjinore në operacione. Programi u prezantua në Ministrinë e FSK-së në fillim të vitit 2012. Pastaj filloi trajnimi me departamentet relevante të Ministrisë, si Departamenti i BCU-së, etj . Në shkurt të vitit 2012 Shtabit të NATO-s në Sarajevë iu bashkua Këshilltari për Çështje Gjinore, me paraqitjen e një seminari mbi ndikimin operacional të gjinisë tek shefat e departamenteve të tjera në MFSK, si dhe përfaqësuesit e Komandës së Forcës Tokësore. Hapi tjetër ishte të informojë Komandën e Forcës Tokësore mbi ndikimin operacional të gjinisë dhe të paraqes apo ta bëj të njohur një rrugë ose mënyrë që në të ardhmen të zbatohet mëtejshëm në njësitë vartëse. Tani pothuajse të gjitha kuadratet e FSK-së, më shumë se 300 pjesëtarë, kanë marrë pjesë në një paraqitje të shkurtër për çështje gjinore. Këshilltari për Çështje Gjinore është përgjegjës për pjesët operative të organizatës, për të mbështetur operacionin, mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit, rritjen e efektivitetit operacional dhe ndërgjegjësimin për situatën. Është e rëndësishme që të nxjerrim në pah ndikimin operacional të gjinisë dhe të shpjegojmë se si një perspektivë gjinore mund të kontribuojë për FSK-në me shembuj dhe skenarë. Këshilltari për Çështje Gjinore dha shembuj se si mund të zbatohet koncepti gjinor. Por, pse është e nevojshme që të përdorim perspektivën gjinore? Në përputhje me misionin e FSK-së, për të përfaqësuar dhe për t'i shërbyer (jo për t' i mbrojtur) gjithë popullit të Kosovës, është e rëndësishme për t' i dëgjuar dhe për t'iu përgjigjur si burrave ashtu edhe grave. Duke marrë parasysh perspektivat e ndryshme ofrohet përgjigje më e plotë që siguron se burimet janë përdorur në mënyrë efikase për të ndihmuar gjithë popullsinë. Por, çfarë do të thotë të ketë një perspektivë gjinore? Të ketë një perspektivë gjinore është që të jetë në gjendje për të zbuluar nëse burrat dhe gratë (të vjetër-të rijnë, që jetojnë në qytete apo jetojnë në fshat, të edukuar lart apo të arsimuar ulët, ...) si pasojë e gjinisë së tyre preken në forma të ndryshme nga një operacion. Kjo nuk ka të bëjë me pjesëtarët e FSK-së. Kjo ka të bëjë me popullsinë e Kosovës dhe është shumë e rëndësishme. Jo të gjitha operacionet kanë dimension gjinor të tyre, por problemi është që të identifikohet nëse ka një dimension të tillë. Ndonjëherë identifikimi është i vështirë, mirëpo trajnimi dhe praktika jep frytet e saj. Me fjalë të tjera që të ketë një perspektivë gjinore do të thotë të shqyrtohet çdo çështje apo problem nga pikëpamja e burrave dhe grave për të identifikuar dallimet në nevojat dhe prioritetet e tyre. Pra, zbatimi i një perspektive gjinore rrit vetëdijen për situatën dhe të çon në vendime më efektive. Përveç rritjes së ndërgjegjësimit për situatën, një perspektivë gjinore rrit efektivitetin dhe është një shumëzues apo koeficient i forcës. Përfitimet e saj gjithashtu përfshijnë edhe mbledhjen e informatave dhe mbrojtjen e forcës. Koncepti gjinor, është miratuar në nivel strategjik. Tani është koha për ta bërë atë funksional, pastaj përmes trajnimit të brendshëm të FSK-së, ajo mund të zbatohet në nivelin taktik. Rruga për ecje përpara është vazhdimi i trajnimit të mëtejmë për organizimin e FSK-së dhe për të identifikuar liderët në fushën e gjinisë, që do të shërbejnë në rolin e këshilluesit për komandantët dhe kuadratet kryesore të personelit apo stafit. Kjo nuk është në të vërtetë një detyrë shtesë. Kjo është vetëm një mënyrë tjetër për të bërë atë që ju tashmë jeni duke e bërë. Ky program ka marrë miratimin e komandantit dhe plani ka qenë i rafinuar dhe i bazuar në udhëzimin e Komandës. Këshilltari për Çështje Gjinore ka informuar personelin si dhe komandat vartëse. Pjesa më e rëndësishme e programit është që të ofrojë një pasqyrë të qartë të përfitimeve për përdorimin apo qëllimin e perspektivave të ndryshme (të shumëllojshme/ diversive).

Major Claire WOHLSCHAK
Këshilltar për Çështje Gjinore i Komandantit të KFOR-it

Certifikohen 27 oficerë të FSK-së për logjistikë



Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, për një javë rresht është mbajtur trajnimi për logjistikë. Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë familjarizimi me konceptet e reja, doktrinat dhe zhvillimin e logjistikës. Trajnimi është mbajtur nga instruktorët e Ushtrisë së Turqisë, enkas, për pjesëtarët e FSK-së. Këtë trajnim e kanë ndjekur 27 pjesëtarë të FSK-së, të përfaqësuar nga të gjitha njësitet e saj. Në ceremoninë përmbyllëse të trajnimit, morën pjesë gjeneral brigade Zymer Halimi dhe Gëzim Hazrolli, kolonel Skënder Hoxha dhe shefi i mentoruesve të Ushtrisë së Turqisë, kolonel Omer Faruk Bashturk. Me këtë rast, gjeneral brigade Zymer Halimi i ka falënderuar instruktorët nga Turqia për kontributin që janë duke dhënë në ngritjen e kapaciteteve profesionale për FSK-në, jo vetëm në logjistikë, por edhe në të gjitha fushat e mundshme. Gjeneral Halimi, nga oficerët e FSK-së, kërkoi që njohuritë e fituara nga ky trajnim t`i bartin me sukses në njësitet e tyre, ku ata veprojnë.

Në emër të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastaratit dhe komandantit të Forcave Tokësore gjeneralmajor Rraman Ramës instruktorët e Ushtrisë turke i ka përshëndetur gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendës komandant i KFT-së. Ai njëherësh ka falënderuar instruktorët për ndihmën e pakursyer që po japin në trajnimin e oficerëve të FSK-së. Koloneli Omer Faruk Bashturk, ka shprehur kënaqësi të veçantë që ka pasur mundësi të punoi me pjesëtarët e FSK-së. "Ndihem i nderuar që kam pasur mundësi që dijen time ta përcjellë të pjesëtarët e FSK-së", duke shtuar se i njëjti trajnim mbahet edhe në Turqi. Të gjithë instruktorët e Turqisë kanë një përvojë jashtëzakonisht të madhe. Ky shkëmbim i përvojave me FSK-në, për ne, do të thotë shumë, andaj kërkoi zbatimin e tyre në njësitet e FSK-së.

Në fund, gjeneral Zymer Halimi drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, në emër të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastratit iu dha certifikata oficerëve të cilët ndoqën këtë trajnim dhe instruktorëve të Ushtrisë së Turqisë; nënkolonelit Hunkar Toyoglu dhe majorëve; Bahtiyar Eren, Latif Oygur, Hakan Buke, si dhe një medalje për Qendrën e Partneritet për Paqe të Turqisë nga e cila qendër vijnë edhe këta instruktorë.

FORCA JONË

∗ ∗ ∗ Viti II • Nr. 10 • mars 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës ∗ ∗ ∗



Turqia mbështet FSK-në

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për një vizitë zyrtare qëndroi ministri i Mbrojtjes së Ushtrisë së Turqisë, Ismet Yelmaz. Ministri turk u prit nga ministri dhe zëvendësministrat e FSK-së, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjeneralmajor Rrahman Rama dhe nga stafi më i lartë i FSK-së.

Gjeneralit Lengyel i la përshtypje profesionalizmi i FSK-së

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti në takim zëvendësshefin e Zyrës së Gardës Kombëtare të Uashingtonit, gjenerallejtënant Joseph Lengyel.

Me këtë rast, gjeneral Kastrati e njoftoi gjeneralin Lengyel me të arriturat e deritashme, me sfidat dhe me objektivat e FSK-së për këtë vit. Ai falënderoi gjeneralin Lengyel për ndihmën që ushtria amerikane është duke i dhënë FSK-së, në fushën e trajnimeve dhe donacioneve, përmes stafit të oficerëve që janë në FSK dhe përmes ekipit këshillues të NATO-s. Po ashtu, gjeneral Kastrati vlerësoi lartë bashkëpunimin e mirë me SHBA-të, e në veçanti



bashkëpunimin e mirë dhe intensiv me Gardën Kombëtare të Ajovës, si në këmbimin e delegacioneve ashtu edhe në fushën e shkollimit dhe të trajnimeve si fushat më me interes për FSK-në. Gjeneral Kastrati e njoftoi delegacionin amerikan edhe për rëndësinë e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë në Kosovë, pasi gjatë këtij viti do të përcaktohet edhe struktura e ardhshme e FSK-së.

Gjenerallejtënant Joseph Lengyel në fjalën e tij shprehu kënaqësinë e veçantë për arritjet e shpejta të FSK-së dhe për shkallën e profesionalizmit të saj. Po ashtu, ai u shpreh tejet i kënaqur edhe për nivelin e mirë të bashkëpunimit në mes Ushtrisë së SHBA-ve dhe FSK-së, duke premtuar bashkëpunim edhe më intensiv në të ardhmen.



Shënohet “Epopeja e UÇK-së”

Qeveria e Republikës së Kosovës, më 5, 6 dhe 7 mars 2013 organizon manifestimin gjithëpopullor në nderim të "Epopesë së UÇK-së" dhe në kujtim të Komandantit legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe gjithë dëshmorëve të kombit dhe të rënëve për liri.
Manifestimi do të mbahet më: 5, 6 dhe 7 mars.

PROGRAMI:

Më 5 mars 2013
Në Kazermën e FSK-së "Adem Jashari" në Prishtinë mbahet ceremonia ushtarake e FSK-së, duke filluar nga ora 11:00, e përcjellë edhe me një program kulturor-artistik nga Ansambli "Shota" dhe këngëtarët e njohur të estradës shqiptare.

Më 6 mars 2013
Në Kompleksin Memorial në Prekaz nga ora 10:00-12:00 do të mbahen homazhe në nderim të Komandantit legjendar, Adem Jashari dhe Familjes Jashari, si dhe në të gjitha komplekset memoriale të dëshmorëve të UÇK-së në Kosovë. Ndërsa në orën 18.00, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, do të mbahet Akademia Përkujtimore kushtuar Komandantit legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit.
Akademia do të përmbyllet me një program artistik.


Më 7 mars 2012
"Nata e Zjarreve" fillon nga ora 18:00 në sheshin "Adem Jashari" në Skenderaj, ku do të ndizen flakadanë të zjarreve dhe do të përcillen me një program kulturor-artistik.

Ftohen qytetarët që në mënyrë masive t’u bashkohen manifestimeve dhe së bashku ta nderojmë veprën heroike të Komandantit legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve për lirinë e popullit tonë.

Bashkëpunim i ngushtë në mes FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për një vizitë pune, qëndroi një delegacion i lartë i Gardës Kombëtare të Ajovës, i prirë nga komandanti i saj gjeneralmajor Timothy Orr. Delegacioni u prit nga zëvendësministri Shemsi Veseli. Në takim ishin të pranishëm edhe Bejtush Gashi-zëvendësministër, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Zymer Halimi, major Hoxha etj.

Me këtë rast zëvendësministri Shemsi Veseli falënderoi gjeneralin Orr për gjithë atë që po bëjnë SHBA-të për Kosovën dhe FSK-në, si dhe e njoftoi për zhvillimet e fundit në FSK. Ndërsa, drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi, përmes një paraqitje të shkurtër prezantoi para të pranishmëve punën e FSK-së deri me tani, si dhe shkollimin, trajnimet dhe ngritjen profesionale të pjesëtarëve të saj. Gjeneral Halimi të pranishmit i njoftoi edhe për gatishmërinë operacionale dhe për procedurat e dërgimit të trupave jashtë vendit.



Gjeneralmajori Timothy Orr falënderoi stafin e lartë të Ministrisë dhe të FSK-së për mikpritjen. Ai njëherësh shprehu admirimin e veçantë për arritjet profesionale të FSK-së dhe gatishmërinë e tij për bashkëpunim të dyanshëm në shumë fusha të përbashkëta, me theks të veçantë në fushën e trajnimeve, shkollimeve etj.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës premtoi mbështetjen e vazhdueshme për FSK-në gjatë ushtrimeve me ekipe mobile në përgjithësi, e në veçanti trajnime në fushën e komunikimit.

Turqia mbështet FSK-në



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për një vizitë zyrtare qëndroi ministri i Mbrojtjes së Ushtrisë së Turqisë, Ismet Yelmaz. Ministri turk u prit nga ministri dhe zëvendësministrat e FSK-së, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjeneralmajor Rrahman Rama dhe nga stafi më i lartë i FSK-së.

Ministri i Mbrojtjes së Turqisë u nderu me nderime të larta nga Togu i Nderit dhe nga Orkestra Frymore e FSK-së e cila ekzekutoi himnet e të dyja shteteve.

Pas fotografisë së përbashkët, në hollin e MFSK-së, të dy ministrat biseduan kokë më kokë për të vazhduar takimin e përbashkët në nivel të zgjeruar të të dy delegacioneve.

Në takim morën pjesë edhe zëvendësministri i FSK-së Shemsi Veseli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjeneralët Zymer Halimi dhe Bashkim Jashari, sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Syla, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Haxhi Shala, Shemsi Syla-këshilltar politik i ministrit dhe nënkolonel Hasan Hoxha -zv. shef i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim. Ndërsa pjesë e delegacionit turk ishte ambasadorja e Turqisë në Prishtinë, zonj. Songul Ozan, Rifat Sait-anëtar i Kuvendit të Turqisë, gjeneral brigade Rafet Sashmaz- zv. shef i Planeve të Përgjithshme dhe Politikave, kolonel Ibrahim Nuhoglu-shef i kabinetit, Osman Jildririm-atashe, znj. Bahar Ozkan-këshilltare për çështje politike etj.

Ministri Çeku, pasi i dëshiroi mirëseardhje homologut të tij z. Ismet Yilmaz, falënderoi Turqinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes për ndihmat që po japin për Kosovën dhe FSK-në. Gjatë takimit ministri i FSK-së e njoftoi ministrin turk për të arriturat e FSK-së, bashkëpunimin ndërkombëtar si dhe planin e zhvillimit për vitin 2013. Pas takimit të përbashkët në nivel të dy delegacioneve, në konferencën e zhvilluar për media, ministri Çeku tha: "Unë fillimisht e falënderova ministrin Yilmaz për të gjithë kontributin e madh që ka dhënë dhe po jep Turqia në ndërtimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe në procesin e formimit të shtetit dhe të integrimit të Kosovës në të gjitha organizmat ndërkombëtare si: BE, NATO, OKB etj.

Mbështetja e tyre ka qenë shumë konkrete, shumë e vlefshme dhe vazhdon të mbetet shumë e nevojshme në të ardhmen ". Turqia ka qenë dhe është një mbështetës jashtëzakonisht i fuqishëm i Kosovës, nëpër të gjitha krizat që ka kaluar Kosova drejt realizimit të synimeve tona.

Turqinë e kemi pasur pranë që nga formimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Turqisë kanë qenë një ndër mbështetësit më të mëdhenj që kanë ndihmuar në ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së.

Ministrin e Mbrojtjes së Turqisë e informova edhe për të arriturat e FSK-së deri në këtë periudhë, për objektivat tona që i kemi për vitin 2013, për ecurinë e rishikimit të procesit të FSK-së, për sfidat që po kalojmë, për angazhimin tonë të përditshëm në ndihmë institucioneve mbrojtëse civile dhe qytetarëve të Kosovës. Sa i përket bashkëpunimi dypalësh ne e kemi një marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes së Turqisë, marrëveshje e cila na afron hapësirë dhe mundësi të mëdha për bashkëpunim sidomos në shkollimin dhe edukimin e oficerëve dhe nënoficerëve tanë. Deri më tani kanë kaluar gjithsej 140 pjesëtarë nëpër shkollat ushtarake të Turqisë. Momentalisht i kemi edhe 14 pjesëtarë, 6 prej tyre janë duke vijuar studimet për pilotë të helikopterëve në Akademinë Ushtarake në Turqi, dhe ne shumë shpejt do t'i kemi këto kapacitete në FSK.

Gjithashtu, me Turqinë e kemi një marrëveshje në fushën e industrisë ushtarake, ku për çdo vit përfitojmë një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare të cilat i shfrytëzojmë për blerjen e pajisjeve tona nga industria ushtarake e Turqisë. Kemi filluar të pajisemi edhe me autoblinda. Deri më tani kemi dy autoblinda. Së shpejti do të pajisemi edhe me tri autoblinda të tjera dhe do të vazhdojmë në këtë drejtim. Është një lajm i mirë që na dha ministri turk për Parlamentin e Turqisë, i cili e ka aprovuar edhe një ndihmë financiare për FSK-në. Me qëllim që bashkëpunimi ynë të jetë sa më i suksesshëm, ne vendosëm që të shkëmbejmë edhe atashe ushtarak në ambasadat tona. Biseduam edhe për përfshirjen e FSK-së në kuadër të operacioneve paqeruajtëse të Turqisë, aty ku ata janë të angazhuar.

Në rrafshin ndërkombëtar, Turqia si vendi me ushtrinë e dytë për nga numri është zë i fuqishëm në kuadër të NATO-s. NATO-ja është duke diskutuar për FSK-në dhe ne kërkuam nga përfaqësuesi i tyre që t'i përshpejtojë këto procese, duke i aprovuar kapacitetet tona operacionale; të vendosë për raportet formale në mes FSK-së dhe NATO-s dhe t'i jap mundësi FSK-së që jetë pjesë e operacioneve të udhëhequra nga NATO; të mbështet FSK-në si një forcë që i duhet Kosovës por edhe NATO-s gjithashtu.

Ndërsa, Ministri i Mbrojtjes së Turqisë, z. Ismet Yilmazm, pasi që falënderoi Ministrin Çeku, shtoi "Ne, në takimin e përbashkët, biseduam për marrëdhëniet ndërshtetërore, për bashkëpunimin tonë dhe për ngjarjet rajonale. Gjithashtu biseduam edhe për dialogun dhe e përkrahim këtë. Dera e dialogut nuk duhet mbyllur asnjëherë, pasi pakënaqësitë e reja mund të sjellin edhe armiqësi të reja. Për neve ruajtja e integritetit territorial dhe sovraniteti politik i Kosovës është jetik dhe gjithsesi duhet të përkrahet dhe mbrohet.

Ne besojmë se Kosova së shpejti do ta zërë vendin e saj në komunitetin ndërkombëtar. Turqia e shpreh përkrahjen e saj në të gjitha sferat për Kosovën.

Kosova është një vend i pavarur dhe i barabartë i Ballkanit. Republika e Kosovës duhet të ketë ushtrinë e vet, ashtu siç e kanë të gjitha shtetet e pavarura dhe sovrane". Ai ka premtuar se Turqia do ta mbështesë në vazhdimësi Forcën e Sigurisë së Kosovës në rrugën drejt transformimit në ushtri të rregullt.



Memorandum Bashkëpunimi në mes të MFSK-së dhe SHLP 'Tempulli'



Në vazhdën e bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të Ministrisë së FSK-së dhe universiteteve të Kosovës, ditë më parë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të MFSK-në dhe Shkollës së Lartë Profesionale "Tempulli".

Memorandumin për MFSK-në e nënshkroi sekretari i përgjithshëm dr. Shkëlzen Syla, ndërsa, në emër të Shkollës së Lartë Profesionale e nënshkroi drejtori i SHLP-së "Tempulli" Muhamed Krasniqi.

Qëllimi i nënshkrimit të këtij memorandumi është bashkëpunimi i dyanshëm në gjitha fushat përkatëse në mes të këtyre dy institucioneve.

Ministria për FSK-në do ta mbështesë Shkollën e Lartë Profesionale "Tempulli" në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me misionin e saj, ku në rast të ndonjë fatkeqësie elementare natyrore do ta ndihmojë me personel dhe teknikë, bazuar në politikat e këtij institucioni dhe kompetencat e MFSK-së dhe FSK-së.

Ndërsa, Shkolla e Lartë Profesionale "Tempulli"do ta mbështesë MFSK-në dhe FSK-në në ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të saj, me programet e saj arsimore në të gjitha nivelet. Po ashtu stafit të MFSK-së dhe FSK-së që ndjekin kurset dhe studimet akademike në këtë universitet do t'i afrojë lirim prej 10%.


FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Intervistë me kolonelin amerikan Edward Thomas

FSK-ja promovon stabilitetin në vend, në rajon dhe më gjerë

FSK-ja mëson shpejt dhe i adopton shpejt praktikat e dëshmuara



"Forca Jonë": *Kolonel, ekipi i juaj mbajti një trajnim treditor në FSK në fushën e marrëdhënieve me publikun, komunikimit dhe paraqitjes në media. Çfarë mund të na thoni lidhur me këtë trajnim?*

Kolonel Thomas: "Motoja e Komandës së SHBA-ve në Evropë është "'Së bashku më të fortë". Andaj edhe trajnimi kishte të bënte me të qenit më të fortë së bashku. Ne i ndamë praktikat më të mira dhe metodat tona për të siguruar një strategji efektive të komunikimit në tërë Ministrinë dhe FSK-në dhe ofruam këshilla lidhur me atë se si të jeni përherë e më efektivë kur e rrëfeni tregimin shumë të mirë të FSK-së.

"Forca Jonë": *Meqenëse trajnimi ishte i nivelit profesional, a janë të mjaftueshme vetëm tri ditë që FSK-ja të përfitojë prej tij?*

Kolonel Thomas: Tri ditë, edhe pse shumë të ngjeshura trajnimi, nuk mund ta bëjnë secilin pjesëmarrës profesionist në komunikim. Unë i kam kaluar afro tri dekada duke punuar në këtë drejtim. Megjithatë, ky ishte edhe një hap i rëndësishëm drejt profesionalizimit të FSK-së. MFSK-ja do të vazhdojë të bëhet vazhdimisht më e arrirë në komunikim me qytetarët e saj, fqinjët dhe audiencën ndërkombëtare. Ky është proces, pjesë e të cilit dëshiroj më të vazhdojmë të jemi si miq dhe partnerë të forcave tuaja.



Ne e kemi shumë të qartë që FSK-ja i ka bërë shumë gjëra jashtëzakonisht mirë. Kjo dëshmohet me faktin se FSK-ja është institucioni më i respektuar i sigurisë në Kosovë. Njerëzit tuaj janë të përkushtuar, të mençur dhe të pasionuar për misionin e tyre, dhe kjo gjë shihet haptazi. FSK-ja është padyshim një forcë për të mirë në rajon dhe jeni pishtar në sigurimin e së ardhmes së ndritshme të Kosovës.

"Forca Jonë": *Kolonel, cilat janë përshtypjet tuaja dhe të ekipit tuaj për këtë trajnim?*

Kolonel Thomas: "Jam absolutisht i impresionuar me perceptimin dhe mjeshtërinë e koncepteve të ministrit Çeku, stafit të tij të lartë dhe të gjithë pjesëmarrësve. FSK-ja mëson shpejt dhe i adopton shpejt praktikat e dëshmuara.

Ligjërimi në këtë trajnim ka qenë vërtet privilegj për mua dhe për tërë ekipin tim. Lidhjet tona me FSK-në janë edhe më të forta tani dhe ne e vlerësojmë shumë lart lidhjen me këtë ekip të mrekullueshëm.

"Forca Jonë": *A keni diçka për t'i shtuar intervistës që unë nuk ju kam pyetur?*

Kolonel Thomas: Trajnimi u zhvillu në dy pjesë. Pjesa e parë e trajnimit kishte të bënte me këshillime (konsultime), ndërsa e dyta me aftësimin (trajnimin) e pjesëmarrësve.

Ishte e rëndësishme që së pari të dëgjonim dhe të mësonim gjatë këshillimeve. Kosova është vend i ri dhe me perspektivë, por i ka disa sfida shumë komplekse të komunikimit. Nuk mund të kuptohen plotësisht sfidat në një kohë të shkurtër.

Trajnimi ka përfshirë edhe diskutime në klasë lidhur me strategjinë e komunikimit, teorinë dhe diskutimet praktike lidhur me krijimin dhe teorinë e mesazheve. Në fund, trajnimi ka përfshirë aftësimin e medieve edhe në përdorimin e kamerave, me qëllim që t'ju ndihmohet pjesëmarrësve t'i përsosin aftësitë e tyre për t'ia transmetuar audiencës tregimin e mrekullueshëm të FSK-së.

Në përmbledhje, ne mësuam se FSK-ja është forcë e përkushtuar për të siguruar të ardhmen e Kosovës. Ky është tregimi i FSK-së. Ky tregim i përmban temat e qarta që FSK-ja është për të gjithë njerëzit - është shumetnike dhe profesionale; FSK-ja është e përkushtuar ndaj transparencës dhe FSK-ja e promovon stabilitetin në vend, në rajon dhe më gjerë.

Intervistë me oficeren e dalluar të Forcës së Sigurisë së Kosovës, major Remzie Zeqiraj

Vendosmëria, ndër faktorët shtytës për arritjen e rezultateve

Major Remzie Zeqiraj ka marrë titullin trajner për media, pas përfundimit të trajnimit "Media trajner" (5 nivele) në Shkup të Maqedonisë

Major Remzie Zeqiraj është njëra ndër oficeret më të dalluara për angazhimin dhe për arritjet profesionale në FSK-së. Ajo punon në Departamentin për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ka kryer Fakultetin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, dhe me sukses të shkëlqyeshëm ka mbrojtur temën e Masterit, në fushën e gazetarisë. Gjatë luftës dhe më pas në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe tani në FSK po e kryen me sukses detyrën e saj të informimit publik.

Në pyetjen tonë, se si e zgjodhi të bëhet ushtare, major Zeqiraj, na thotë: "Ne duhet të jemi të gjithë përherë ushtarë të atdheut. Unë mendoj se e gjithë veprimtaria si edhe vet qenia ime i është dedikuar shërbimit ndaj atdheut. Angazhimi praktik në të mirë të çlirimit të vendit më ka radhitur si luftëtare në luftën e UÇK-së. Me një grup shokësh të veprimtarisë kombëtare kemi zgjeruar shtrirjen e UÇK-së, në rajonin e Istogut (prej nga jam unë), dhe nga bashkëluftëtarët kam marrë besimin për të kryer detyrën e zëvendëskomandantit për Informim në kuadër të Brigadës 133 "Adrian Krasniqi" të Zonës Operative të Dukagjinit, detyrë të cilën e kam kryer derisa jam plagosur në vijat e frontit, në betejën e 12 prillit 1999. Pas procesit të shërimit nga plagët, pas një viti, jam kthyer prapë në uniformë, në radhët e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës. Me ngritjen e FSK-së, jam pranuar në detyrën shef i Komunikimit dhe Informatikës në Komandën e Brigadës për Reagim të Shpejtë, me gradën kapiten, pastaj jam ngrit edhe në gradë dhe në detyrë. Tani kryejë detyrën e oficerit për Marrëdhënie me Publikun në Departamentin për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në pyetjen, se si po arrin t'i kryejë të gjitha detyrat, major Zeqiraj, shton: "Jam e bindur që; sinqeriteti, puna e vazhdueshme, angazhimi konkret dhe puna e përhershme, janë elementet kryesore që e bëjnë një ushtarak të dalluar. Dhe secili nga ushtarakët duhet të veprojnë fuqishëm, duke sjellë edhe iniciativa personale pozitive, me qëllim që si tërësi, si kolektivitet, të ecim me hapa të sigurt përpara, drejtë ngritjes së profesionalizimit në shkallën më të lartë të FSK-së.



Falë profesionalizimit që ka, major Zeqiraj ka fituar besimin tek të tjerët, të cilët gjithmonë e marrin si shembullin më të mirë, për arritjen e sukseseve: "Për të kontribuar për të mirën e përgjithshme, për të qenë e dobishme dhe shembull në punë, si dhe për të qenë e suksesshme, potencialet duhet orientuar në fushën që e dëshiron më së shumti, në drejtimin që t'i di ta bësh më së miri në përgjithësi. Për të arrit në cakun e dëshiruar, patjetër që duhet ta kesh vullnetin, profesionalizmin dhe vendosmërinë, pavarësisht sfidave që ndeshesh. Përkundrazi, vështirësitë janë faktor shtytës për një sukses të synuar. Kjo ka qenë përherë mënyra ime e punës, duke e dashur punën dhe mënyrën time të të bërit të saj.

Major Zeqiraj, kohë më parë ka kryer me sukses edhe një trajnim të nivelit të lartë për marrëdhënie me publikun, në Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë, në Shkup. ku ka fituar të drejtën e instruktores në këtë fushë. Për këtë sfidë mjaft provokuese ajo shton: "Kjo ka qenë një përvojë shumë pozitive dhe besojë se tërë dijen që kam fituar me besnikëri do ta përcjellë tek gjeneratat e reja, në FSK, të cilat janë shumë të guximshëm dhe vazhdimisht angazhohen në të gjitha drejtimet".

Ndërsa në pyetjen se si ju shohin kolegët dhe shoqëria kosovare? Ajo jep këtë përgjigje.

"Me bindje të plotë e them se këtu nuk ndjehet asnjë lloj paragjykimi, unë çmohem për punën dhe për angazhimin tim, po ashtu çmohem edhe si oficere, këtë e ndjej edhe në raport me qytetarët, çdo herë reagimet e tyre dhe komentet kanë qenë të mira dhe frymëzuese, këtë e shoh në sytë e tyre se e çmojnë angazhimin e një ushtarakeje. Populli ynë e ka dëshmuar shumë herët këtë, e ka vlerësuar dhe vazhdon ta vlerësojë lartë angazhimin e femrës në të gjitha sferat e në veçanti në ushtri".

Mesazhi i saj, për gjeneratat e reja, është: "Të zhvillohen si karaktere të forta ashtu siç din një femër të jetë. Të zhvillohen profesionalisht dhe të mos e paragjykojnë asnjëherë vetveten. Puna dhe suksesi do të ecin bashkë, pa fije dyshimi".

Paradë dinjitoze e FSK-së në 5-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Në sheshin qendror të Prishtinës, me rastin e pesëvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, parakaluan kuadratet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave. Në këtë ceremoni morën pjesë zyrtarët më të lartë të Kosovës, të Republikës së Shqipërisë, të Republikës së Maqedonisë etj.



Kuadratet e njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës së bashku me kuadratet e Policisë së Kosovës si dhe të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, parakaluan solemnisht në manifestimin qendror shtetëror, që u mbajt më 17 shkurt 2013, me rastin e 5-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në sheshin "Nëna Terezë" dhe"Zahir Pajaziti"në Prishtinë.

Në manifestimin qendror morën pjesë; presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga, kryeparlamentari Jakup Krasniqi, kryeministri i Kosovës Hashim Thaqi, kryetari i Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani, kreyparlamentarja e Shqipërisë Jozefina Topalli, ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë Arben Imami, ministri i Mbrojtjes së Maqedonisë Fatmir Besimi, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjenerali Orr, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Shqipërisë gjeneral Xhemal Gjunkshi, ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit Qeveritar dhe qytetarë të shumtë nga e gjithë Kosova, si dhe ambasadorë dhe atashe të akredituar në Prishtinë.

Në manifestim me rastin e shënimit të 5-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, folën: presidentja e Kosovës, zonja Atifete Jahjaga, zv. ambasadorja e Mbështetjen më të madhe FSK-ja e ka nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë ditë edhe presidenti amerikan Barak Obama ka dërguar një letër, të cilën e lexoi zv. ambasadorja e SHBA-ve Kelly Degnan. "SHBA-të vlerësojnë të arriturat e shtetit të Kosovës në këto pesë vjet. Ky përparim në veçanti është i dukshëm në zhvillimin e sektorit të sigurisë së Kosovës. Gjatë pesë vjetëve të shkuara FSK-ja, Policia e Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave kanë luajtur rol jetik për t'i mbajtur qytetarët të sigurt dhe të qetë. Ju keni treguar se Kosova mund të jetë kontribuuese e sigurisë këtu në vend dhe në rajon dhe askush nuk duhet ta zhvleftësojë këtë të arritur", tha Degnan. Zv. ambasadorja amerikane ritheksoi mbështetjen e SHBA-ve edhe më tej në ngritjen profesionale të FSK-së.

"SHBA-të dhe Kosova kanë shumë programe të përbashkëta. Njëri prej shembujve më të mirë të bashkëpunimit tonë është ai ndërmjet komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe Forcës Tokësore të FSK-së. Në saje të këtij bashkëpunimi, në Kursin për liderë luftarakë, që nga fillimi i vitit të kaluar janë trajnuar dhe i kanë përforcuar shkathtësitë e tyre më shumë se 200 nënoficerë të FSK-së", tha ajo.



Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Kelly Degnan dhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi.

Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, në ditën e shënimit të pesëvjetorit të pavarësisë në fjalën e saj tha: "Liria dhe pavarësia e vendit është fituar me punën e pakursyer të gjithë popullit të Kosovës. Kjo fitore është arritur edhe me përkrahjen e fuqishme ndërkombëtare. Kjo na obligon që të ndërtojmë shtetin dhe shoqërinë demokratike. Të krijojmë një ambient të qetë dhe të sigurt, të ndërtojmë një vend në të cilin të gjithë qytetarët jetojnë dhe punojnë lirshëm"

Ndërsa për parakalimin e FSK-së tha; "Parakalimi juaj sot e nderon punën tonë, profesionalizmin dhe besimin tuaj në shërbim të shtetit, në shërbim të gjithë qytetarëve. Përkushtimi në punën tuaj ju lartëson dhe ju dallon".

Mbështetjen më të madhe FSK-ja e ka nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë ditë edhe presidenti amerikan Barak Obama ka dërguar një letër, të cilën e lexoi zv. ambasadorja e SHBA-ve Kelly Degnan. "SHBA-të vlerësojnë të arriturat e shtetit të Kosovës në këto pesë vjet. Ky përparim në veçanti është i dukshëm në zhvillimin e sektorit të sigurisë së Kosovës. Gjatë pesë vjetëve të shkuara FSK-ja, Policia e Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave kanë luajtur rol jetik për t'i mbajtur qytetarët të sigurt dhe të qetë. Ju keni treguar se Kosova mund të jetë kontribuuese e sigurisë këtu në vend dhe në rajon dhe askush nuk duhet ta zhvleftësojë këtë të arritur", tha Degnan. Zv. ambasadorja amerikane ritheksoi mbështetjen e SHBA-ve edhe më tej në ngritjen profesionale të FSK-së.

"SHBA-të dhe Kosova kanë shumë programe të përbashkëta. Njëri prej shembujve më të mirë të bashkëpunimit tonë është ai ndërmjet komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe Forcës Tokësore të FSK-së. Në saje të këtij bashkëpunimi, në Kursin për liderë luftarakë, që nga fillimi i vitit të kaluar janë trajnuar dhe i kanë përforcuar shkathtësitë e tyre më shumë se 200 nënoficerë të FSK-së", tha ajo.

Një fjalë rasti në këtë përvjetor e mbajti edhe kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, i cili tha, se:"Liria dhe Pavarësia e Kosovës ka qenë ëndërr e gjyshërve tanë, e baballarëve tanë dhe e të gjithë neve që jetojmë sot në shtetin e Kosovës. Të gjithë së bashku ëndrrën e shndërruam në realitet".

Kreu i Qeverisë e vlerësoi si një mesazh të fortë parakalimin e FSK-së, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave.

"Parakalimi i djemve dhe vajzave tona sot, është mesazh i qartë i vizionit tonë që Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës janë duke punuar me përkushtimin të lartë për përmbushjen e standardeve " tha ai.

Më pas, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i raportoi presidentes së Kosovës për gatishmërinë e kuadrateve të paradës për parakalim, dhe me urdhër të presidentes Jahjaga, filluan parakalimet e kuadrateve të FSK-së, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave.

Në përvjetorin e 5-të të shpalljes së Pavarësisë, në sheshin kryesor të Prishtinës, parakaluan kuadratet e të gjitha njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës, fillimisht paradës i priu; Togu Ceremonial i FSK-së, për të vazhduar me kuadratin e Batalionit të Parë të BRSH-së, Batalionit të Dytë të BRSH-së dhe Batalionit të Tretë të BRSH-së, kuadrati i Brigadës për Mbështetje Operacionale, kuadrati i Regjimentit të Mbrojtjes Civile dhe kuadrati i kadetëve të Qendrës për Studime Universitare.

Për herë të parë së bashku me kuadratet e FSK-së parakaluan edhe 4- kuadrate të Policisë së Kosovës; të prirë nga kuadrati i Policisë Patrulluese, kuadrati i Njësisë Speciale Operacionale, kuadrati i Njësisë Speciale Inervenuese, kuadrati i Policisë së Kosovës K9, dhe një kuadrat i Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave. Të gjitha kuadratet gjatë parakalimit u përcollën nga Orkestra Frymore e FSK-së dhe nga duartrokitjet e shumta të qytetarëve të Kosovës.

Parada u përmbyll me parakalimin e automjeteve të FSK-së, të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave të Kosovës.





FORCA JONË

Intervistë me nënkolonel Arsim Shaqirin, komandant i Batalionit të Tretë të BRSH-së në Mitrovicë

Batalioni i Tretë dallohet për angazhi në realizimin e detyrave

Batalioni i Tretë i BRSH-së në Mitrovicë është njëri ndër batalionet më të dalluara për ngritjen profesionale të pjesëtarëve. Këtë e kanë dëshmuar pjesëtarët e saj me pjesëmarrjen e tyre në shumë trajnime, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke zënë vendet e para. Ky nivel i arritur nuk është spontan, por është reflektim i përvojës dhe punës së palodhshme të tyre dhe të udhëheqësit të këtij batalioni të FSK- së Andaj për të kuptuar më mirë për zhvillimet e tërësishme të BRSH-së, biseduam me komandantin e këtij batalioni nënkolonel Arsim Shaqirin.

"Forca Jonë": *Për fillim z. komandant një përshkrim të shkurtër për Batalionin e Tretë?*
Nënkolonel Arsim Shaqiri: Batalioni i Tretë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH) i ka katër kompani, tri operacionale dhe një mbështetëse. Batalioni vepron sipas direktivës së komandantit të BRSH-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, udhëzuesit të komandantit të batalionit, si dhe planeve vjetore e mujore të përgatitura nga Komanda e Batalionit. Trajnimet e brendshme të batalionit mbahen nga instruktorët e saj të licencuar nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) dhe KFOR-i, me të cilët kemi bashkëpunim të mirë. Batalioni i Tretë është dalluar për arritjen e rezultateve në trajnime, qoftë brenda dhe jashtë vendit, si në Amerikë, Turqi, Maqedoni etj.



"Forca Jonë": *Cila është struktura e pjesëtarëve të Batalionit të Tretë ?*
Nënkolonel Arsim Shaqiri: Zakonisht kur flasim për pjesëmarrjen e komuniteteve në Batalionin e Tretë, kjo çështje ka rëndësi të veçantë për arsye se ne të gjithë personelin e trajtojmë në mënyre të njëjtë dhe shumë profesionale. Me këtë dua të them se në Batalionin tonë është kultivuar ajo frymë e lidershipit ku nuk është me rëndësi se kush është kush, por kush dhe çfarë autorizimesh, detyrash dhe përgjegjësish ka në njësi, andaj edhe trajtohet si i tillë. Nga gjithsej 359 pjesëtarë, sa është e paraparë t'i ketë struktura e Batalionit të Tretë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë e FSK-së, për momentin është plotësuar me 351 veta, ku prej tyre në përgjithësi ka pjesëtarë të të gjitha komuniteteve, si shqiptarë, boshnjakë, turq, romë, ashkali etj.

"Forca Jonë": *Kohëve të fundit Batalioni i Tretë ka arritur rezultate lakmuse gjatë trajnimeve, ç'mund të na thoni për këtë vlerësim?*
Nënkolonel Arsim Shaqiri; Ne, derisa nuk jemi të angazhuar në operacione, punojmë në bazë të këtij parimi"Trajnimi është gjithçka dhe e kundërta e saj, se gjithçka është trajnimi". Tek ne dominon një frymë profesionale si në nivel të komandës së batalionit, ashtu edhe në nivel të kompanisë. Si rezultat i tërë kësaj çdo pjesëtarë në batalion, trajnohet 8x7x1 në vit, apo thënë më mirë 365 ditë të vitit .
Sistemi i trajnimit dhe edukimit në FSK është i rregulluar në atë mënyrë që çdo ditë kemi trajnime të brendshme në nivel batalioni, ku vlen të ceket rregulla 8x7x365 ditë. Mund të përmendim disa nga këto trajnime në nivel të FSK-së, si trajnimi në BRSH (Brigada e Reagimit të Shpejt), ku kanë ndjekur kurse dhe trajnime të ndryshme më shumë se 105 pjesëtarë; në KFT 81 pjesëtarë dhe në KDS 213 pjesëtarë.



"Forca Jonë": *Cilat janë aktivitetet tjera të rëndësishme të Batalioni të Tretë?*
Nënkolonel Arsim Shaqiri: Gjatë vitit të kaluar, kemi pasur aktivitete të shumta trajnuese kolektive, si më të arriturat kanë qenë ushtrimi në Postëkomandë dhe ushtrimi fushor të realizuar në BRSH, pastaj pjesëmarrja në grupin planifikues të Ushtrimit Fushor të KFT-së. Kemi qenë forcë opozitare gjatë Ushtrimit Fushor të FSK-së dhe njëherësh kemi qenë edhe njësi rezervë e komandantit të KFT-së.

"Forca Jonë": *Çfarë mund të na thoni për bashkëpunimi tuaj me KFOR-in dhe me strukturat tjera udhëheqëse?*
Nënkolonel Arsim Shaqiri: Kemi një bashkëpunim të





min maksimal



shkëlqyeshëm me të gjitha institucionet e sigurisë dhe institucionet tjera, në zonën e përgjegjësisë së Batalionit të Tretë. Me Komunën e Mitrovicës po ashtu bashkëpunojmë ngushtë, madje kemi realizuar edhe një ushtrim fushor në nivel komunal, ku pjesëmarrës kanë qenë të gjitha institucionet relevante komunale. Ky trajnim është realizuar nga personeli i Batalionit të Tretë.

Gjithashtu kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm me KFOR-in. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, me Batalionin Rezervë Taktik i KFOR-it, kryejmë aktivitete sociale, vizita të ndërsjella dhe me fokus të veçantë trajnime, ku kjo njësi na ofron trajnime të rregullta në bazë të nevojave të identifikuara për njësinë tonë. Vetëm gjatë vitit të kaluar kemi realizuar më shumë se njëzet (20) trajnime të ndryshme, në të cilat janë trajnuar 376 pjesëtarë. Një bashkëpunim të mirë e kemi me Ekipin Trajnuese të Turqisë, me të cilin gjatë vitit që lamë pas kemi realizuar 17 trajnime të ndryshme, ku kanë marrë pjesë 333 pjesëtarë të trajnuar në tema të ndryshme.

Gjithashtu, ne realizojmë edhe trajnime të koordinuara nga



Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati dhe shefi i Shtabit të Ushtrisë së Shqipërisë, gjeneral Gjunkshi, bënë homazhe në Prekaz

Gjeneralët nderojnë komandantin legjendar

Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati, së bashku me shefin e Shtabit të Ushtrisë së Shqipërisë, gjeneral Xhemal Gjunkshin dhe me oficerë të lartë të FSK-së, ditën e 17 shkurtit, pesëvjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës e filluan pikërisht në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", ku bënë homazhe dhe vendosen kurora me lule. Delegacioni më pas qëndroi për një vizitë edhe në familjen Jashari, ku u prit nga vëllai i madh i Komandantit Legjendar, Rifat Jashari. Me këtë rast, gjeneralët Gjunkshi dhe Kastrati e çmuan lartë sakrificën e pashembullt të familjes Jashari për liri dhe pavarësi.



Kapiten Çobani: Pjesëtarët e Batalionit të Tretë, të shkëlqyeshëm

Gjatë vizitës që i bëmë Batalionit të Tretë të BRSH-së në Mitrovicë, në poligonet e saj takuam pjesëtarët e Kompanisë 3A, të cilët po ushtronin praktikisht njërin nga ushtrimet më sfiduese, për të cilin më parë i kishin kaluar edhe mësimet teorike.

Kapiten Murat Çobani, njëri nga instruktorët kryesor të KFOR-it turk, pa hezitim dhe me krenari na tha: "Ne e kemi kryer një trajnim mjaft të rëndësishëm në fushën teorike, ndërsa tani kemi filluar trajnimin praktik. Përparimi i lëvizjes së Skuadrës dhe Togës, në një vijë brenda këtyre temave; pozicioni i qitjes, lëvizja, zvarritja, lëvizjet individuale dhe ato në grupe, po shkojnë sipas planifikimit dhe mësimeve teorike, dhe për këtë jam shumë i kënaqur, sidomos me përparimin e djemve dhe vajzave të Batalionit të Tretë. Këta janë shumë të gatshëm t'i zënë mësimet qofshin ato teorike apo praktike. Kjo vërtetë më gëzon shumë dhe ndihme krenar për këtë, na tha në fund kapiten Çobani.

Ndërsa, toger Haxhi Haliti përgjegjës për trajnime në kuadër të Batalionit të Tretë të BRSH-së, tha se ky trajnim është vazhdimësi e trajnimeve të mëparshme të cilat shkojnë me lëvizje-rotacion. Tani po punojmë me pjesëtarët e Kompanisë 3A, ndërsa, pas 4 muajve vazhdojmë me pjesëtarët e Kompanisë B-C, me të njëjtat trajnime.

Trajnimet po i kryejmë me sukses në bashkëpunim e ngushtë të instruktorëve të KFOR-it turk dhe instruktorëve të Batalionit të Tretë të FSK-së.



komanda madhore edhe me njësitet e tjera të KFOR-it, si me KFOR-n amerikan, gjerman dhe anglez ku janë realizuar më shumë se 10 trajnime të ndryshme me 55 pjesëtarë.

Njëra nder prioritetet tona si njësi është të vazhdojmë me trajnimet dhe edukimin e pjesëtarëve tanë jashtë vendit, nëpër shkollat e NATO-s. Gjatë vitit që lamë pas, nga pjesëtarët e Batalionit të Tretë jashtë vendit janë ndjekur 10 trajnime/shkollime dhe kurse në të cilat kanë marrë pjesë 28 pjesëmarrës nga të gjitha nivelet. Në këto trajnime personeli i batalionit tonë ka treguar rezultate të shkëlqyeshme, ku janë nderuar me çmime të ndryshme si "Honor Graduate","Çmimi për Lidership" dhe "Njeriu i Hekurt". Këto janë vetëm disa nga çmimet e fituara nga personeli ynë, dhe besoj se kjo është dëshmia më e mirë për të treguar përkushtimin dhe profesionalizmin e pjesëtarëve të Batalionit të Tretë të BRSH-së .

"Forca Jonë": *Z. komandant, cili është vizioni juaj për të ardhmen e Batalionit të Tretë?*

Nënkolonel Arsim Shaqiri: Vizioni i im për të ardhmen e Batalionit të Tretë është të jemi pjesë e NATO-s, të kemi një strukturë lehtësisht të integrueshme në NATO me ligje, rregullore dhe PSO komfor kritereve të NATO-s, me pajisje të standardizuara dhe me përgatitje të lartë profesionale. Me arritjen e këtyre objektivave mendoj se do të jemi në hap me të gjitha ushtritë e NATO-s.

Fotoreportazh nga parakalimi në paradën e 17 shkurtit 2013













FORCA JONË

* * * Viti II • Nr. 11 • prill 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri Agim Çeku, ka raportuar para Komisionit Parlamentar për FSK-në



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Agim Çeku, gjatë raportimit para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së ka deklaruar se i vetmi projekt i papërfunduar në kuadër të institucioneve shtetërore është Forca e Sigurisë. E çfarë kapacitetesh do t'i ketë, për këtë do të vendosë Parlamenti, sepse ky proces do të na çojë drejt nevojës për ndryshimin e Kushtetutës etj. Tani është koha që Kosova ta ketë forcën reale të sigurisë. Të gjitha këto do të kalojnë përmes Parlamentit, ka thënë ministri i FSK-së, Agim Çeku.

Në këtë takim merrnin pjesë edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, sekretari i përgjithshëm i FSK-së, Shkëlzen Sylaj dhe këshilltari i NAT-it, Kevin Linch, etj.

Ministri Çeku ka elaboruar veç e veç gjashtë objektivat e tij për zhvillimin e FSK-së për vitin 2013, si shkollimin, trajnimet, bashkëpunimin ndërkombëtar, formimin e Task-Forcës së kërkim-shpëtimit, rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë etj. "Si rezultat i angazhimit të përgjithshëm, ky vit ishte vit i suksesshëm për FSK-në, sidomos në arritjen e objektivave të FSK-së", tha ministri Çeku. Ai raportoi edhe për mundësinë e aprovimit të Kapaciteteve të Përgjithshme Operacionale nga ana e Këshillit Veri-Atlantik të NATO-s, si dhe shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve për kryerjen e misionit kushtetues dhe në ndihmë autoriteteve civile dhe komuniteteve.

Vazhdimi i ngritjes dhe ndërtimi i vlerave të identitetit, fizibilitetit, fuqizimi i bashkëpunimit dypalësh rajonal, bashkëpunimi dhe partneriteti me NATO-n dhe rishikimi i sektorit të strategjik të sigurisë janë me prioritet për ne, etj.

Ministri Agim Çeku shpalosi edhe prioritetet për vitin e ardhshëm; që FSK-ja të bëhet forcë e vetqëndrueshme dhe të vazhdojë t'i zhvillojë kapacitetet operacionale, të bëhet forcë e besueshme, e aftë, aktive, vizibile dhe partner i përkushtuar i SHBA-ve, NATO-s dhe BE-së.

Më pas, ministri Çeku i ka njoftuar anëtarët e Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, se FSK-ja është duke bërë rishikimin, një studim shkencor dhe se janë duke u identifikuar nevojat dhe mundësitë që ka. Kjo do të marrë kohë, por ky është një proces që po shkon në rrugën dhe dinamikën e duhur. Kosova do t'i ketë institucionet e sigurisë, të gjitha ato që i nevojiten, dhe besoj se do t'i ketë më të mirat. "Sa e madhe do të jetë, çfarë kapacitetesh do të ketë, do të vendosë Parlamenti, sepse ky proces do të na çojë drejt nevojës për ndryshimin e Kushtetutës. Pra, të gjitha këto do të kalojnë përmes parlamentit", ka thënë ministri Çeku.

Pas raportimit të ministrit Çeku, shumica e deputetëve e përgëzuan ministrin për të arritur at e FSK-së si dhe u interesuan të dinë më shumë për pjesëmarrjen e komuniteteve, identifikimin e rreziqeve të mundshme etj.

Raportimi i ministrit Çeku në Komisionin Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së u zhvillua në kuadër të raportimit vjetor.

FSK-ja ndihmoi qytetarët e Klinës pas përmbytjeve



Ekipet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) pas përmbytjeve nga reshjet e shiut që ndodhën më 14 mars, në shumë vendbanime në Kosovë, kanë ndërmarrë një operacion shpëtimi për t'i ndihmuar qytetarët e prekur nga vërshimet në shumë vendbanime, sidomos në Komunën e Klinës dhe Skënderajt etj. Ekipet e Njësisë për Reagim në Kriza (NJRK), kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes, në zonat e përmbytura nga vërshimet, në Komunën e Klinës dhe atë të Skenderajt, ku pas vlerësimit të situatës, në ndihmë të menjëhershme ka shkuar një njësit i Regjimentit të Mbështetjes Civile, Kompania e Kërkim-Shpëtimit e FSK-së, me 21 pjesëtarë, me 3 barka dhe 4 automjete. Kompania ka kryer intervenime në fshatin Zajm, Komuna e Klinës dhe në disa fshatra të Komunës së Skënderajt. Në fshatin Zajm, nga ekipet e FSK-së, janë kontrolluar të gjitha shtëpitë të cilat kanë qenë të përmbytura me qëllim që mos ka mbetur ndonjë qytetarë i ngujuar. FSK-ja, gjithashtu ka intervenuar edhe në restorantin Guri i Zi (i cili gjendet buzë Drinit, në rrugën për Gjakovë), ku ka evakuuar 6 qytetarë dhe pronarët e tij, të mbetur të ngujuar pas përmbytjeve të shiut. Intervenimin e njësive të FSK-së, e kanë përshëndetur dhe falënderuar banorët e kësaj ane.

FSK-ja dhe KFOR-i amerikan demoluan një bombë 500-kilogramësh



Kompania e deminimit të FSK-së ka hulumtuar mbi 900.000 metra katrorë dhe kanë asgjësuar mbi 3000 mjete të pashpërthyera si: mina, bomba, kasetë bomba, eksploziv etj.

Deminerit e Kompanisë së FSK-së, së bashku me ata të KFOR-it amerikan, në Harilaq, (afër kodrës së Goleshit), kanë demoluar me sukses një bombë të përmasave të mëdha, mbi 500 kilogramë

Bombën e ka zbuluar Rrahman Sllamiku, punëtor i kompanisë Eko-Kos, i cili ka qenë duke marrë material guri për shtrimin e oborrit të kësaj kompanie.

Demінerët e Kompanisë së FSK-së dhe ata të KFOR-it amerikan, me ta marrë mesazhin nga Ministria e FSK-së (Qendra operative) për gjetjen e një bombe, nga një punëtor i kompanisë Eko-Kos në Harilaq, afër Kodrës së Goleshit, menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes si dhe kanë marrë të gjitha masat përkatëse për mosrrezikimin e jetës së qytetarëve. Ata kanë përkufizuar vendin dhe, pasi kanë bërë pastrimin e vendit dhe bombës, kanë vërtetuar se bomba ka mbetur si pasojë e luftës së fundit në Kosovë.

Komandanti i Kompanisë së Deminimit të FSK-së, major Fadil Sahiti, tha se: "Kjo është bomba më e madhe e gjetur deri më tani. Është prodhim anglez dhe ka këto dimensione; 1.40 metra e gjatë, 40 cm diametri dhe mbushja me mbi 113 kilogramë eksploziv, ku pesha e përgjithshme e bombës, arrin në 500 kilogramë".

Sipas eksperteve të FSK-së dhe KFOR-it amerikan, rrezikshmëria e kësaj bombe është shumë e madhe dhe rrezja e veprimit është diku prej 2000 mijë metrash.

Dje ekipet e deminimit të FSK-së dhe të KFOR-it amerikan kanë punuar vazhdimisht deri në orët e vona dhe pas analizave të përbashkëta, ata kanë marrë vendim për largimin e bombës në një vend të tjetër për shkak të rrezikshmërisë së saj që mund të ketë për banorët e kësaj ane dhe drejtpërdrejt për objektin e kompanisë Eko-Kos.

Sipas ekspertëve të këtij lëmi, thuhet se bomba është hedhur nga ajri dhe është e tipit gjysmë bind-shpues, që duhet të kuptohet se është për goditjen e objekteve të bunkerizuara dhe efekti është; që pas depërtimit në brendësi të objektit, ajo shpërthen.

(Vijon në faqen 6)



Ministri Agim Çeku priti në një takim ambasadorin e Anglisë, Jan Klif

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së) Agim Çeku, i shoqëruar edhe nga Shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK zoti Kevin Linç (Kevin Linch), priti në MFSK, në vizitë zyrtare ambasadorin e Anglisë zotin Jan Klif (Ian Cliff).

Në këtë takim në mes të ministrit Agim Çeku dhe ambasadorit Klif u diskutua për ecurinë e procesit të Rishikimit Sektorit Strategjik të Sigurisë (RSSS), si dhe për mbështetjen dhe kontributin që Britania e Madhe mund ta jap në zhvillimin e këtij procesi.

Memorandum Mirëkuptimi në mes Ministrisë së FSK-së dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Shkëlzen Sylaj dhe mbikëqyrësi kryesor shtetëror Ruzhdi Jashari nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më 1 mars 2013 nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi, ndërmjet këtyre dy institucioneve.

Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afateve themelore, në bazë të të cilave Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pajtohen t'i realizojnë në përputhje me mandatin dhe kompetencat ligjore.

Këto të dy institucione do t'i bashkërendojnë aktivitetet për realizimin e misionit të tyre të bazuara në ligjet e aplikueshme të Republikën e Kosovës. Po ashtu Ministria për FSK-në do t'i ofrojë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mundësi për trajnimin dhe certifikime të nëpunësve të saj në fushën e standardeve të sigurisë, si dhe kurse të gjuhëve të huaja.



Komandanti i KFOR-it përcolli nga afër trajnimet e FSK-së



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, për një vizitë pune më 12 mars, ka qëndruar komandanti i KFOR-it, gjenerali Volker Halbauer me bashkëpunëtorë.

Komandantin e KFOR-it, e priti komandanti i KDS-së gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili me këtë rast e ka njoftuar gjeneralin Halbauer me të arriturat e përgjithshme të KDS-së; misionin, trajnimet të cilat janë duke u mbajtur, si dhe planin e trajnimeve për vitin 2013.

Të dy gjeneralët së bashku me oficerë të FSK-së dhe KFOR-it, i kanë përcjellë trajnimet të cilat janë duke u mbajtur në Qendrën Stërvitore të KDS-së, si: kursin për lider luftarak, kursin i avancuar për oficer, laboratorët e gjuhëve të huaja, simulatorin e qitjes dhe poligonin e qitjes.

Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe KFOR-it.

Në fund, komandanti i KFOR-it u shpreh i kënaqur me punën që po bëhet në KDS e veçmas me trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së.

Gjeneralmajor Rrahman Rama mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Fuqisë Ajërore dhe Hapësinore në Turqi



Zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Rrahman Rama, me ftesë të komandantit të Forcave Ajrore të Turqisë, gjeneral Mehmet Erten (gjeneral me katër yje), ka marrë pjesë në Konferencën e Parë Ndërkombëtare për Fuqinë Ajrore dhe Hapësinore, që u mbajt ditë më parë në Stamboll të Turqisë.

Delegacioni i FSK-së ishte mysafir i veçantë i komandantit të Forcave Ajrore të Republikës së Turqisë.

Kjo është Konferenca e Parë Ndërkombëtare për Fuqinë Ajrore dhe Hapësinore që është mbajtur në Stamboll. Konferenca ka pasur për qëllim diskutimin dhe shtjellimin e çështjeve të luftës mbizotëruese të forcave ajrore në ditët e sotme dhe përshtatjen e kësaj teknologjie në ambientet moderne të luftëbërjes në të ardhmen.

Gjatë tri ditëve, sa ka zgjatur konferenca, shumë studiues të këtij lëmi dhe gjeneralë kanë prezantuar tema të ndryshme për forcat ajrore dhe hapësinore në një audiencë të përfaqësuar nga pjesëmarrës të 54 shteteve të botës.

Në ditën e parë të konferencës, gjeneralmajor Rrahman Rama pati takime me komandantin e Forcave Ajrore të Republikës së Turqisë, gjeneralin Mehmet Erten, ku kanë biseduar për bashkëpunimin në mes të dy institucioneve. Gjeneral Rama e ka falënderuar gjeneralin Erten për ndihmën dhe kontributin e shtetit dhe të ushtrisë turke që po japin në vazhdimësi për zhvillimin, trajnimin dhe modernizimin e FSK-së. Gjeneral Erten ka premtuar që edhe në të ardhmen ta ndihmojë FSK-në. Gjeneral Rama ka takuar edhe shumë gjeneralë të shteteve pjesëmarrëse, ku ka biseduar për zhvillimet e dyanshme.

Studentë të Universitetit "Durham" të Londrës vizituan FSK-në

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, ka pritur një grup studentësh të Universitetit "Durham" nga Anglia, të cilët i njoftoi për historinë e shqiptarëve, për arritjet e përgjithshme të FSK-së, si dhe rishikimin e sektorit strategjik të sigurisë.

Ministri Çeku shkurtimisht elaboroi zhvillimin e luftës së UÇK-së gjatë vitit 1997-1999, ndërsa për KFOR-in dhe UNMIK-un tha se ka për mision të krijojë një ambient paqe. Që nga viti 2008, edhe pse Kosova ka shpallur Pavarësinë, ne përpara kemi shumë sfida, por jemi duke e vendosur vendin tonë në hartën politike botërore, ndërsa për NATO-n tha se është pjesë e rëndësishme e historisë, por edhe e së ardhmes sonë.

Ministri për FSK-në tha se është një proces zhvillimi sipas Pakos së Ahtisarit, ku, sipas saj, jemi të kufizuar në këtë drejtim, por Ahtisari ka thënë se këto kufizime zgjasin 5 vjet nga shpallja e Pavarësisë. Tani 5 vjet po i bëjmë në muajin qershor, dhe qysh tash jemi duke punuar në rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë së bashku me miqtë tanë ndërkombëtarë, që edhe ne të kontribuojmë në sigurimin e paqes rajonale. Ministri iu përgjigj shumë pyetjeve të studentëve, të cilët kishin të bënin me të ardhmen e FSK-në, Kosovës, bashkëpunimin në rajon etj.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati përcolli nga afër trajnimet në BRSH





Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Operacione në FSK, gjeneral Zymer Halimin, zv. komandantin e KFT-së gjeneral Gëzim Hazrollin, kolonel Xhevahir Gecin, zv. komandant i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Istog, nënkolonel Fadil Hadërgjonaj, shefin e Sektorit për Trajnime dhe Stërvitje etj, më 11 mars, qëndruan për një vizitë pune në Brigadën për Reagim të Shpejtë, në Gjilan.

Për të arriturat e përgjithshme të Batalionit të Parë të BRSH-së, i njoftoi major Ibrahim Revuqi, shef i Operativës. Në takim morën pjesë edhe pjesëtarë të KFOR-it dhe këshilltarë të NAT-it. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati i përcjelli njësitet gjatë kryerjes së trajnimeve në terren, të cilët në bashkëpunim me përfaqësuesit e KFOR-it turk, po kryenin trajnimet "lëvizjet taktike" me Kompaninë 1-B, ndërsa, pjesëtarët e Kompanisë 1-A po kryenin trajnimet e procesit të vendimmarrjes. Trajnimet po i menaxhonin instruktorët e KFOR-it turk dhe të FSK-së, së bashku edhe me pjesëtarët e KFOR-it-Lindje. Komandanti i FSK-së, me këtë rast, takoi edhe të gjithë pjesëtarët e komuniteteve të cilët janë në FSK, i cili u interesua të dijë më shumë për kushtet, detyrat dhe suksesin e secilit veç e veç. Në fund gjeneral Kastrati, ka përshëndetur të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe instruktorët e KFOR-it, për punën dhe për arritjet e FSK-së. "Qëllimi i vizitës sonë është që nga afër të përcjellim dhe të njoftohemi me punën dhe detyrat që po i realizoni, qoftë në aspektin individual dhe atë kolektiv". Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, për të gjitha të arriturat e FSK-së, ka falënderuar edhe KFOR-in, Gardën Kombëtare të Ajovës dhe komandantin e saj, gjeneralin Orr dhe pjesëtarët e KFOR-it turk, të cilët po japin një kontribut të madh në trajnimin e FSK-së, që ta kryejnë misionin e saj. "Ne jemi duke punuar ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë, KFOR-in, SHBA-të etj, në realizimin e trajnimeve, shkollimin dhe përmbushjen e standardeve në të gjitha fushat, për FSK-në" shtoi gjeneral Kastrati

Në fund, komandanti i FSK-së, kërkoi nga të gjithë pjesëtarët e FSK-së angazhimin e tyre maksimal në realizimin e detyrave, dhe me punë të jenë shembull për të tjerët dhe njëherësh të marrin përgjegjësi të reja, në këtë drejtim.



Vizitë pune edhe në Brigadën për Mbështetje Operacionale

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 12 mars, qëndroi për një vizitë pune edhe në Brigadën për Mbështetje Operacionale (BMO) për tu njohur me realizimin e detyrave të përditshme.

Në takim ishin të pranishëm edhe stafi më i lartë i BMO-së, FSK-së dhe përfaqësues të NAT-it. Për të arriturat e përgjithshme të BMO-së, komandantin e njoftoi kolonel Ilaz Dërguti, komandant i BMO-s. "Qëllimi im është t'i vizitojë të gjitha njësitet e FSK-së, si dhe të marrë informacione për kryerjen e detyrave.

Ai e njoftoi stafin udhëheqës të BMO-së, për punën që po bëhet në përgjithësi edhe për rishikimin e sektorit të sigurisë. Gjeneral Kastrati ka kërkuar angazhimin e gjithë stafit udhëheqës të BMO-së dhe pjesëtarëve të saj, angazhim maksimal, për realizmin e detyrave të përgjithshme qoftë; në trajnime, shkollim dhe përmbushjen e standardeve në gjitha fushat etj. Gjeneral Kastrati, shembull shumë pozitiv në këtë drejtim, i përmendi sukseset e Kompanisë së Deminimit, MKAB-së dhe Task Forcën e Kërkim-Shpëtimit.

"Këto njësi kanë dhënë shembuj të profesionalizmit gjatë intervenimit të tyre në shumë raste. Për këtë, këto njësi janë të përgatitura dhe të gatshme edhe për operacione humanitare jashtë vendit". Gjeneral Kastrati kërkoi nga të gjithë jo vetëm realizmin e detyrave, por edhe përgatitje fizike, "sepse përgatitja fizike është jo vetëm standard, por edhe kulturë e njësive për aftësimin e tyre fizikisht, sidomos të atyre njësive që marrin pjesë edhe në operacione jashtë vendit".



Në fund gjeneral Kastrati kërkoi angazhim maksimal për realizimin e trajnimeve dhe shkollimin e pjesëtarëve të FSK-së, sepse "për mua gjëja më e rëndësishme është përgatitja profesionale dhe fizike", tha në fund komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati.

FSK-ja shënoi 15- vjetorin e manifestimit “Epopeja e UÇK-së”



Në Kazermën "Adem Jashari" të FSK-së, nderohet komandanti legjendar Adem Jashari, familja Jashari dhe të gjithë dëshmorët dhe martirët e kombit.

Nën përkujdesjen e kryeministrit të Qeverisë së Kosovës z.Hashim Thaçi, FSK-ja, në 15- vjetorin e luftës heroike të Komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari dhe familjes Jashari, ka organizuar manifestimin qendror, me moton; "Nderojmë Historinë-Ndërtojmë të Ardhmen". Manifestimi u mbajt në kazermën "Adem Jashari", në të cilën morën pjesë; presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, kryetari i Parlamentit të Kosovës, Jakup Krasniqi, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, përfaqësues të familjes Jashari; Rifat dhe Bekim Jashari, ministra të kabinetit qeveritar, drejtues të institucioneve shtetërore të Kosovës, deputet, përfaqësues të komunitetit fetarë, qytetarë, nxënës dhe studentë të Prishtinës.

Fillimisht, presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, inspektuan kuadratet e FSK-së. Manifestimi filloi me ngritjen e flamurit nga Togu ceremonial i FSK-së dhe me intonimin e himnit kombëtar dhe shtetëror të Republikës së Kosovës, ekzekutuar nga Orkestra frymore e FSK-së. Presidentja Jahjaga, kryetari i Parlamentit Krasniqi, kryeministri Thaçi dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, vendosen kurora me lule pranë Obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, fillimisht, përshëndeti familjarët e familjes Jashari dhe të dëshmorëve, veteranët, presidenten, kryeministrin, kryetarin e Kuvendit, ministrin e FSK-së, mysafirët vendorë dhe ata ndërkombëtarë, si dhe ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FSK-së.

"Epopeja UÇK-së është epope e shkruar në analet e historisë, studiuesve dhe strategëve të artit ushtarak, Epope që ka kryepersonazh familjen emblematike të kombit tonë, familjen e komandantit legjendar Adem Jashari", tha në fillim general Kastrati.



"Në këtë 15- vjetor ne po vazhdojmë avancimin e institucionit tonë, institucion ky që po tregon, ndërtuar në shtetin e ri, shtetin e Kosovës i cili themelet i ka në sakrificën e kombit.

Të nderuar të pranishëm!

Për të nderuar këtë ngjarje të madhe janë rreshtuar para nesh kuadratet e FSK-së, që tregojnë përkushtimin e Kosovës për të ndërtuar forcën e vet ushtarake. Forcë të cilën e kishin ideuar dhe vulosur me sakrificën dhe heroizmin e tyre, komandanti legjendar Adem Jashari me bashkëluftëtarët e tij".

Të nderuar të pranishëm!

"FSK-ja, sot po arsimohet, po ngitet profesionalisht, po zhvillohet dhe modernizohet në bashkëpunim me NATO-n. FSK-ja çdo ditë po dëshmon se është një partnere e denjë dhe mund të sot në liri, përfundoi fjalën e tij, general Kastrati.





Përmasat e këtij flijimi legjendar e zgjuan ndërgjegjen e botës demokratike. Gatishmëria për disiplinë, profesionalizëm, përkushtim dhe gatishmëri për marrjen e përgjegjësive kombëtare e ndërkombëtare, duke e ndihmuar vendin tonë në synimin e tij, anëtarësimin në familjen e madhe të sigurisë globale. Institucioni ynë, FSK-ja, është punojë krahas NATO-s, në çdo mision. Bashkëpunimi që kemi ndërtuar me NATO-n është arritje e madhe e cila vlerësohet nga të gjithë, andaj ne sot u jemi mirënjohës miqve tanë ndërkombëtarë për atë që kanë bërë dje në luftë dhe për atë që po bëjnë Ndërsa, kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, pasi përshëndeti familjen Jashari dhe të pranishmit, tha: "Me rreshtimin dhe parakalimin e trupave të FSK-së po fillon shënimi i 15 -vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Sot, kur institucionet më të larta shtetërore të Kosovës po ndërojnë njërën nga ngjarjet më të ndritura dhe heroike të historisë sonë të re, sot, kur Kosova është njohur nga rreth 100 shtete, sot Kosova e lirë dhe sovrane, po nderon heroizmin e komandantit legjendar Adem Jashari, sakrificën e familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve dhe dëshmorëve të lirisë.

fitoren e lirisë e zgjoi një komb të tërë.

UÇK-ja bashkoi të gjithë, kudo që ishin, qytetarët shqiptarë, në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Preshevë, në Mal të Zi e diasporë, kudo, prandaj sot të gjithë përulemi për sakrificën e qytetarëve shqiptarë për lirinë e Kosovës.

UÇK-ja u bë zëri autentik i vullnetit të qytetarëve tanë. Këtë vizion të lirisë, humanizmit dhe demokracisë, e mbështeti edhe bota e përparuar. E mbështetin shtetet e demokracisë perëndimore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet e Bashkimit Evropian, aleanca më e fuqishme ushtarake e botës, NATO.

Dëshmi e përkushtimit tonë institucional për perspektivën tonë euroatlantike, jeni vetë ju, të nderuar pjesëtarë të FSK-së, që me profesionalizmin tuaj, bëni që të jemi krenarë.

Me ju janë krenarë qytetarët tanë, me ju është krenarë shteti i Kosovës. Përkushtimi dhe përparimi i Kosovës është objektivi ynë strategjik dhe historik. Përkushtimi për përparimin e Kosovës është respekti më i lartë për të rënët në themelet e lirisë së vendit tone, tha në fund kryeministri Thaçi.

Ndërsa në emër të familjes Jashari, përshëndeti Rifat Jashari vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari: "Lavdia dhe nderi u takon të gjithë atyre që ranë për këtë liri, që ne sot po e gëzojmë"

Në fund ministri dhe komandanti i FSK-së, për disa nga pjesëtarët e FSK-së ndanë mirënjohje për meritat në kryerjen e detyrave të punës, si medaljen për "Shërbime të shquara", medaljen "E ardhmja fillon këtu", medaljen "Reparti i shquar"dhe me medaljen "Vetëmohues" Manifestimi "Epopeja e UÇK-së" më 5 Mars 2013, u përmbyll me një program të pasur kulturo-artistik, me këngëtarët e dalluar: Ilir Shaqiri, Violetë Kukaj, Leonora Jakupi, Riza Bytyqi, Ismet Behxheti, Hysni Klinaku dhe Ansambli Kombëtar i Valleve dhe Këngëve "Shota"



Homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz

Në 15- vjetorin e rënies së komandantit legjendar, Adem Jasharit dhe familjes Jashari, ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati të shoqëruar nga stafi më i lartë i FSK-së, kanë bërë homazhe në Varrezat e Dëshmorëve, në Prekaz.

Ministri i FSK-së Agim Çeku, nderoi dëshmorët së bashku me kryeministrin e Kosovës Hashim Thaçin dhe ministrat e Kabinetit Qeveritar.

Ndërsa, delegacioni i FSK-së, të prirë nga komandanti i FSK-së, gjeneralleitënant Kadri Kastrati, zëvendësministri i FSK-së Shemsi Veseli, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së Shkëlzen Sylaj, komandanti i KFT-së gjeneralmajor Rrahma Rama, gjeneralët: Zymer Halimi, Enver Cikaçi, Gëzim Hazrolli, Haxhi Shala, dhe oficerë të tjerë, më 6 mars vendosen lule të freskëta dhe bënë homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz.

Me këtë akt, nderuan komandantin legjendar Adem Jashari, familjen Jashari dhe të gjithë dëshmorët e kombit.

Komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati, tha: " bashkë me udhëheqësit e FSK-së, jemi këtu për të nderuar veprën e madhe të komandantit legjendar Adem Jashari, të familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit".

Delegacioni i FSK-së, më pastaj vizitoi Kullën e Jasharajve, ku u pritën nga Rifat Jashari, vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari dhe Murat e Lulëzim Jashari.



FSK-ja dhe KFOR-i amerikan demoluan një bombë 500-kilogramësh

(Vijon nga faqja 1)

Sipas komandantit të kompanisë së Deminimit të FSK-së, major Fadil Sahitit, kjo është bomba më e madhe e zbuluar dhe e demoluar nga FSK-ja, kësaj here në bashkëpunim me KFOR-in amerikan. Ai thotë se "këtu (Harilaq) e kemi gjetur dhe demoluar edhe një bombë, të të njëjtit tip, por pesha e saj ka qenë diku 400 kilogramë".

Sot vetëm pas angazhimit nga KFOR-i amerikan të një automjeti të rëndë e të blinduar, të sjellë nga KFOR-i austriak dhe ai zviceran, e kanë hequr bombën nga vendi i mëparshëm dhe vendosjen e saj në një vend të thellë (gropë), dhe pasi paraprakisht kanë marrë masat e sigurisë hapësinore prej tre kilometrash nga Policia e Kosovës, deminerët e kanë shkatërruar me sukses bombën.

Në fund komandanti i kompanisë, major Sahiti, tregon se si pasojë e minave dhe bombave të mbetura në Kosovë kanë humbur jetën mbi 115 qytetarë; fëmijë, pleq, gra, etj. dhe kanë mbetur të lënduar, pa ndonjë gjymtyrë, me pasoja për tërë jetën, mbi 456 veta, më së shumti ka fëmijë. Por, merrni me mend, se në rast të eksplodimit të kësaj bombe, pasojat do të ishin katastrofale, sepse është një bombë shumë e madhe dhe rrezikshmëria e saj do të ishte, për një rreth mbi 4 km. Ky është edhe një sukses i madh i deminerëve të FSK-së, të cilët gjatë kësaj pune kanë hulumtuar mbi 900.000 metra katrorë dhe kanë gjetur dhe asgjësuar mbi 3000 mjete të pashpërthyera si: mina, bomba, kasetë bomba, eksploziv etj.



Zëvendësministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Gani Elshani dhe deputeti Danush Ademi u pritën në Ministrinë e FSK-së



Në Drejtorinë për Politika dhe Plane në MFSK, më 11 mars, qëndruan për një vizitë zyrtare, zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Gani Elshani dhe kryetari i komunitetit ashkali në Kosovë, njëherësh deputet në Kuvendin e Kosovës Danush Ademi.

Ata u pritën nga drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane Haxhi Shala dhe kolonel Skënder Zhitia, drejtori i Departamentit të Personelit në MFSK.

Me këtë rast, drejtori për Politika dhe Plane, Haxhi Shala, mysafirët i njoftoi për arritjet e përgjithshme të FSK-së, për konkursin dhe për mundësinë e përfshirjes së pjesëtarëve të komuniteteve në FSK.

Zotëri Shala i informoj liderët e komunitetit ashklali për konkursin, për kriteret e aplikimit dhe të pranimit në FSK. Ai gjithashtu i njoftoj për takimin me zyrtarë të zyrave për komunitete, në komunat e ndryshme në Kosovë, si dhe për mënyrat e aplikimit.

Ndërsa, drejtori i Departamentit të Personelit kolonel Skënder Zhitia, gjerësisht i informoi të pranishmit, për numrin e përfaqësimit të pjesëtarëve të komunitetit ashkali në FSK, për punën e tyre, pozitat dhe vend-shërbimin në kazermat e FSK-së. Zëvendësministri Elshani dhe deputeti Ademi, shprehen përkrahjen e tyre, si lider të këtij komuniteti, për inkurajimin e pjesëtarëve të komunitetit ashkali, për të aplikuar në FSK, si dhe mundësitë e mbështetjes nga ana e tyre për përfaqësim të këtij komuniteti për t'u bërë pjesë e FSK-së.

Në fund, u kërkua që sa më shumë të rijnë të komunitetit ashkali të aplikojnë në konkursin për shërbim në FSK, ndërsa MFSK-ja/FSK-ja do të jetë e hapur për çdo lloj përkrahje të këtij komuniteti për t'u informuar deri në detaje për mënyrat e konkurrimit, duke i respektuar kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët për shërbim në FSK.

30 infermiere të QKUK-së, kryen trajnim njëjavor në FSK

Në kazermën "Adem Jashari" të FSK-së, në Prishtinë, përfundoi trajnimi njëjavor, me temën, Teknikat e avancuara të ndihmës së parë.

Trajnimi është organizuar nga Departamenti i Mjekësisë së MFSK-së në bashkëpunim me Qendrën për Edukim të Vazhdueshëm të Infermiereve (QEVI) të QKUK-së.

Gjatë trajnimit u ligjërua këto tema: Menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes, Sistemi i qarkullimit të gjakut, Frakturat, Gjakderdhjet, Helmimet, Reanimimi kardiopulmunar, etj.

Trajnimi u mbajt nga instruktorët e FSK-së; major; dr. Rabit Dermaku dhe kapter Lirim Hamiti.

Trajnimin e kanë vijuar 30 infermiere të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Në ceremoninë përmbyllëse të trajnimit, morën pjesë; kolonel Skënder Hoxha dhe nënkolonel Zejnë Prokshi. Kolonel Hoxha në emër të komandantit të Forcave Tokësore ,gjeneralmajor Rrahman Rama, i përshëndeti infermieret dhe i përgëzoi për përfundimin e suksesshëm të trajnimit dhe njëherazi uroj që ky bashkëpunim i mirë në mes QKUK-së dhe Kompanisë së Mjekësisë së FSK-së, të vazhdojë edhe në të ardhmen me avancime më të larta në të gjitha lëmit.

Në fund, infermierja e QKUK-së, Mendehije Hajdari-Qela, falënderoi instruktorët dhe FSK-në, për trajnimin, bashkëpunimin dhe përkrahjen që FSK-ja, po i jep QKUK-së dhe anasjelltas. "Ky bashkëpunim i mirë, në mes Qendrës për Edukim të Vazhdueshëm të Infermiereve (QEVI) të QKUK-së dhe Kompanisë së Mjekësisë së FSK-së, do të vazhdojë edhe në të ardhmen".



Intervistë me pjesëtarë të komuniteteve, të cilët veprojnë në FSK

Snezhana kërkon angazhim dhe disiplinë në kryerjen e detyrave të përditshme

Gjatë vizitës që i bëmë Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, në Gjilan, kërkuam të takohemi me pjesëtarë të komuniteteve dhe të mësojmë më shumë për jetën dhe punën e tyre. Komandanti na propozoi të takoheshim me Snezhana Malokun, me arsyetimin se ajo është njëra ndër eproret më të dalluara e cila realizimin e detyrave e kryen me përgjegjësi të madhe. Ditën e vizitës sonë Snezhana ishte në terren ku po merrte pjesë me ekipet mobile, në fushatën për rekrutimin e pjesëtarëve të komuniteteve.

Me të kuptuar qëllimin tonë ajo na tha se pranon me dëshirë të na jep intervistë për gazetën e FSK-së, "Forca Jonë".

Jam Snezhana Maloku. Me përkatësi etnike jam maqedonase. Në FSK jam prej themelimit të saj, ndërsa më parë kam shërbyer edhe në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës.

Në interesimin tonë, se cilën



detyrë e kryen, në FSK, ajo na thotë: " e kryej detyrën e zëvendës komandantit të Togut të II, Kompania I-B, Batalioni i Parë për Reagim të Shpejtë". Ajo me mburrje dhe krenari thotë se para se të pranohej në FSK, ka shërbyer në Zonën e Gjashtë të TMK-së, këtu në Gjilan. Nuk kam pasur kurrfarë problemi që t'i përshtatem rrethanave të reja, sepse e kam pas një përvojë të mirë nga TMK-ja.

Snezhana ka kryer shkollën e mesme dhe shumë trajnime që e kanë ndihmuar të marrë shumë njohuri të përgjithshme dhe profesionale.

Kur e pyesim për bashkëpunimin në mes komuniteteve Snezhana shton: "Marrëdhëniet në mes të gjithë pjesëtarëve të FSK-së janë të shkëlqyeshme dhe secili i kryen detyrat me përgjegjësi që i takojnë, këtu nuk ka dallime kombëtare, race, ngjyre apo dhe feje". Ajo me dëshirë është angazhuar në ekipet mobile dhe po angazhohet që sa më shumë të rinj të komuniteteve t'i bind për të konkurruar që të bëhen pjesëtarë të FSK-së. Këtu kushtet e punës janë shumë të mira dhe secili angazhohet me përgjegjësi të madhe për t'i kryer detyrat e parashtruara nga eprorët.

Me dëshirë e kam prit gradimin, sepse e kam ndier vetën më të sigurt, pas tri vjetëve punë me përgjegjësi në FSK. Unë shoqërohem me të gjithë pjesëtarët e FSK-së, të gjithë dallohen me kryerjen e detyrave dhe me sjellje shembullore; ne punojmë sipas standardeve më të avancuara".

Ndërsa, rreshteri Agron Mezraja, i cili punon së bashku me Snezhanen, na thotë."Snezhana gjithmonë kërkon angazhim dhe disiplinë në kryerjen e detyrave të përditshme, është bashkëpunuese dhe shumë e sjellshme, ne nuk kemi kurrfarë problemi në komunikim qoftë gjatë mësimit teorik apo praktik".

Para se të ndahemi, Snezhana përsëritë edhe një herë: "Marrëdhëniet në mes të pjesëtarëve të komuniteteve janë të shkëlqyeshme, këtu nuk ka asnjë lloj dallimi dhe të gjithë jemi të barabartë; secili i kryen detyrat me përgjegjësi të madhe".

Ushtar Demiqi dallohet për angazhim në realizimin e detyrave të përgjithshme

Edhe Lubisha Demiç është ushtar i dalluar në Brigadën për Reagim të Shpejtë, këtu në Gjilan. Unë, na thotë, ushtar Demiqi, ndajë mendimin e njëjtë me Snezhanën, kur është në pyetje bashkëpunimi dhe harmonia që mbretëron në BRSH. Jam nga Gjilani dhe punoj në Njësitin Mbështetës. Tani kam bërë përvojë më të gjatë, jam pranuar në vitin 2011 dhe kam kaluar nëpër të gjitha kriteret e konkurrimit, të realizuara sipas standardeve të përgjithshme të FSK-së. Mendoj se shumë shpejt kam arrit t'i përshtatem rrethanave të reja, falë trajnimeve dhe përgatitjeve që i kam kryer në FSK.

"Nuk e kam pritur se do të kaloj kaq mirë, edhe pse në fillim kam pasur vështërsi. Të gjithë shokët më kanë pritë mirë dhe pa dallim. Ne po kalojmë shumë mirë me të gjithë". Ai njëherit i fton edhe të rinjtë e tjerë të komuniteteve që të aplikojnë sa ma shumë, sepse këtu janë kushtet shumë të mira, dhe respekti i përgjithshëm është i dyanshëm. Të njëjtin mendim e ndanë edhe Rexhep Aliu pjesëtar i komunitetit turk, që punon së bashku me ushtar Demiqin.





Ushtar Periqi u bënë thirrje bashkëvendësve që të aplikojnë në FSK

"Jam Millosh Periqi nga Novobërda. Jam pranuar qe një vit e gjysmë në FSK në Brigadën e Reagimit të Shpejtë, në Gjilan. Çdo ditë udhëtoj nga Novobërda për punë dhe anasjelltas dhe kurrfarë probleme nuk kam. Të gjitha testet dhe standardet e kërkuara i kam kaluar që të bëhem pjesëtar i FSK-së. Jam shumë i lumtur që jam pjesë e FSK-së. Për momentin e kryej detyrën e shoferit dhe të gjithë shokët më kanë përkrahë dhe më përkrahin për t'i kryer detyrat e përditshme. Për këtë i falënderoj të gjithë. Jam përshtatur me kohë kushteve dhe rrethanave këtu. Kushtet janë shumë të mira për punë. Ushtar Periqi u bënë thirrje pjesëtarëve të komunitetit të tij, që të aplikojnë sa më shumë në FSK, sepse këtu nuk ka dallime të asnjë lloji. Të gjithë kalojmë shumë mirë. Me të gjithë kuptohemi dhe nuk kemi kurrfarë probleme në komunikim me njëri-tjetrin.

Jo vetëm unë, si pjesëtar i komunitetit serb, por edhe pjesëtarët e komuniteteve tjera si: boshnjakë, ashkalinj, turq etj., asnjëherë nuk kemi pasur probleme. Jeta këtu është shumë aktive. Përveç punëve të përditshme merremi edhe me aktivitete sportive. Sidomos jam adhurues i futbollit dhe i volejbollit. Kushtet për kryerjen e këtyre aktiviteteve sportive janë shumë të mira. Kemi fusha përkatëse sportive. Këtu, në Gjilan në njësitet tjera të FSK-së ka edhe shumë pjesëtarë të tjerë të komunitetit serb".

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj

Certifikohen 22 pjesëtarë të FSK-së në "Kursin për Liderë Luftarakë"

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj më 22 mars përfunduan trajnimin me sukses 22 pjesëtarë të FSK-së në "Kursin për Liderë Luftarakë", gjenerata 13/001. Kursi ka zgjatur tri javë, i strukturuar në grupe të vogla të një formati të udhëhequr nga instruktorët me module në menaxhimin e trajnimit: udhëheqjen ushtarake, shëndeti dhe fitnesi fizik, trashëgimia e trupave të nënoficerëve, historia ushtarake, ndihma e parë dhe navigimi tokësor.
Kursi është udhëhequr nga instruktorët e FSK-së, të cilët janë trajnuar dhe licencuar nga Akademia e Nënoficerëve të Armatës së 7 të Ushtrisë Amerikane në Grafenwehr të Gjermanisë dhe e mbikëqyrur nga ekipi i instruktorëve amerikanë në Kampin Bonsteel të udhëhequr nga kapiten Surh Bryan.
Në ceremoninë e certifikimit



morën pjesë, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, komandanti i KDS-së, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane në Kosovë, kolonel Ray Wojcik, koloneli Will dhe major Peterson nga Kampi Bonsteel dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe të KFOR-it.
Komandanti i KDS-së, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, i përgëzoi kadetët për përfundimin me sukses të këtij kursi, njëherësh falënderoi ekipin e instruktorëve amerikanë për mbështetje.
Ndërsa koloneli Wojcik i uroj të certifikuarit për performancën e treguar gjatë kryerjes së kursit dhe për profesionalizimin, disiplinën dhe përkushtimin e madh, "që po e dëshmon edhe përfundimi me sukses të lartë i kursit për Liderë Luftarakë". Koloneli Wojcik më pas tha se para një viti e gjysmë me gjeneral Ramën dhe Cikaqin bisedonim për Akademinë e Nënoficerëve në Kosovë, ndërsa tash pikërisht pas një viti e gjysmë kurset e nënoficerëve po mbahen këtu, për çka jemi të lumtur të gjithë.
Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me FSK-së edhe në të ardhmen, ndërsa ju ftoj të punoni me oficerët dhe nënoficerët e NATO-s që t'jua jepni mundësinë, që ta kuptojnë se sa jeni të përgatitur profesionalisht.
Rreshteri i Stafit, Cole Harde, instruktor amerikan i cili ka qenë pjesë e ekipit në mbështetje të instruktorëve të FSK-së, shprehu përshtypjet e tij për kursin, instruktorët dhe kadetët: "Kursi ka qenë shumë i mirë. Kam respekt shumë të thellë për instruktorë, të cilët kanë treguar përkushtim. Kjo është hera e dytë që mbahet ky kurs nga instruktorët e FSK-së, mirëpo kanë fituar një përvojë sikur të mbahej me vite të tëra.
Të gjithë instruktorët shprehën fjalë të mira për kadetët, të cilit gjatë mbajtjes së këtij kursi kanë qenë shumë të motivuar, interesimi i tyre për të marrë njohuri ka qenë shumë i lartë, disiplina ishte në nivel që i takon kursit. Thënë shkurt, atë që e kam parë te kadetët e përshkruaj kështu: secilin prej tyre do ta kisha marr në mision", shtoi rreshteri i Stafit Cole Hardee.
Çmimin e kadetit "Udhëheqës" e fitoi rreshteri Naim Mala, çmimin e listës së komandantit e fitoi tetar Rifat Bega dhe çmimin "Ushtari i Hekurt" e fitoi tetar Ilir Hajra, ndërsa certifikata për kryerjen e kursit luftarak me sukses u dhanë të gjithë kadetëve.

Certifikohen edhe 20 instruktorë të Fitnesit Fizik

28 pjesëtarë të FSK-së morën pjesë në një kurs të lartë për Instruktorë të Fitnesit Fizik, mbajtur nga ekipi i instruktorëve të Forcave Ajrore të Britanisë, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj. Kursi ka qenë shumë intensiv, ku janë mbajtur dy cikle: i pari, si zhvillohen ushtrimet në cikël dhe cikli i dytë, ushtrimet fizike në fushëbeteja. Trajnimi ka qenë i ngjeshur me ligjërata dhe aktivitete të rënda fizike, ku kadetë kanë treguar një interesim dhe përkushtim të madh për të përfituar sa më shumë dije dhe aftësi fizike.
Në ceremoninë e certifikimit prezantuan, zv/komandanti i KFT-së, gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli, komandanti i KDS-së, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, koloneli Small Wood, këshilltar i NAT-it në FSK, si dhe oficerë të FSK-së dhe instruktorët e KFOR-it.
Gjeneral Cikaqi në emër të KDS-së e ka falënderuar ekipin e instruktorëve të Britanisë për punën dhe angazhimin e madh, në trajnimin e FSK-së. "Unë ju përgëzoj për arritjet në finalizimin e këtij kursi me sukses, sepse ky ka qenë kursi më sfidues deri më sot, dhe këtë e keni arritur me një përkushtim, angazhim dhe me një qëndrueshmëri falë instruktorëve të Ushtrisë mike të Britanisë.
Qëllimi ynë është që secili që vjen këtu ta përfundojë kursin në mënyrën ma të mirë të mundshme dhe me suksesin më të lartë. Këtë ju e keni arritur me angazhimin e veçantë dhe me punën ekipore dhe unë kërkoj nga ju ta jepni kontributin e juaj



në njësitet e juaja. Objektivi ynë është të krijojmë një korr të nënoficerëve të trajnuar mirë, por në radhë të parë të përgatitur fizikisht shumë mirë, andaj jam shumë i sigurt se edhe ky kurs ka me rritë performancën fizike të të gjithë pjesëtarëve të FSK-së. Trajnimet me instruktorët britanikë gjithmonë kanë qenë shumë sfidues, për këtë arsye edhe sukseset kanë qenë të arritshme.
Ndërsa koloneli Britanik Small Wood, këshilltar i NAT-it për FSK-në, ka përgëzuar të gjithë pjesëmarrësit si dhe instruktorët për punën që kanë bërë në përgatitjen e instruktorëve të FSK-së. Në fund, gjeneral Hazrolli, Cikaqi dhe kolonel Wood u dhanë mirënjohje të gjithë pjesëtarëve të certifikuar, si dhe certifikata i dhanë ekipit të instruktorëve të Britanisë: Wo Newill Smith, RS Mark Newillson dhe PS Max Martin.

2599 nxënës i përcollën ligjëratat për vetëdijesimin nga minat dhe mjetet e pashpërthyera

Në organizim të Departamentit për Bashkëpunimin Civil-Ushtarak dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, drejtoritë e Arsimit në komuna të Kosovës, Qendrën Koordinuese për Deminim në MFSK si dhe Kompaninë e Deminimit, dhe në bazë të planifikimit, kanë realizuar me sukses ligjëratat për vetëdijesim nga mjetet e pashpërthyera (minat), në shkollat fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës.
Bazuar në planin e hartuar që më parë, Kompania e Deminimit të FSK-së sipas urdhëresës nga



KOMRMC, nga data 21 janart 2013, ka filluar mbajtjen e ligjëratave për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, në Kosovë. Sipas raportit të Kompanisë së Deminimit, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur ligjërata në 18 komuna, ku janë përfshirë 50 shkolla dhe ligjëratat i kanë përcjellë gjithsej 2599 nxënës.
Gjatë mbajtjes së ligjëratave, oficerë dhe zyrtarë të Departamentit të BCU-së, bashkë me këshilltarin e NAT-it për BCU-në, kanë realizuar një varg vizitash në shumë shkolla për të përcjellë ecurinë e ligjerimti nga pjesëtarët e FSK-së. Ndërsa, këshilltari i NAT-it, ka lavdëruar pjesëtarët e FSK-së, për formën dhe mënyrën e ligjërimit si dhe përgatitjen e lartë profesionale të instruktorëve të dominimit.
Vetëdijesimin nga mjetet e pa shpërthyera (minat), realizohet tash e sa vite, me qëllim të afrimit të informacioneve të nevojshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës e veçanërisht nxënësve, për rrezikun që mundë të shkaktojnë mjetet e pa shpërthyera. Nxënësit kanë qenë shumë të kënaqur më ligjëratat e pjesëtarëve të FSK-së.

FORCA JONË

* * * Viti II • Nr. 12 • maj 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri Çeku u takua me Admiralin Clingan, komandant i Komandës së Bashkuar të Forcave në Napoli

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), Agim Çeku dhe Komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, zhvilluan një takim, datë; 25 04.2013, me komandantin e Komandës së Bashkuar të Forcave në Napoli, admiralin Bruce Clingan si edhe komandantin e KFOR-it, gjeneral major Volker Halbauer. Takimi u zhvillua në Komandën e KFOR-it, në Prishtinë.
Ministri Çeku e informoj admiralin Clingan, mbi zhvillimet dhe aktivitetet e FSK-së, si edhe për përpjekjet e Ministrisë së Forcës, drejt përmbushjes së planeve dhe objektivave vjetore si edhe perspektivën e FSK-së.
Në takimin e përbashkët ministri Çeku dhe admirali Clingan u angazhuan për vazhdimin e bashkëpunimit për të ardhmen si edhe për kooperim të mëtutjeshëm në mes të FSK-së dhe institucionit që drejton admirali Bruce Clingan.

Akademia e Forcave Luftarake të Turqisë konfirmon bashkëpunimin më intensiv në të ardhmen



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), Agim Çeku dhe komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, në ambientet e MFSK-së, datë; 25.04.2013, pritën, për një vizitë pune, komandantin e Akademisë së Forcave Luftarake të Turqisë, gjeneralmajor Metin Durak me bashkëpunëtorë.
Ministri Çeku e falënderoi gjeneralmajorin Gurak për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet FSK-së dhe Akademisë Luftarake të Turqisë, për përkrahjen e pakursyer që po jep kjo Akademi në të mirë të ngritjes profesionale të oficerëve dhe kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.
Ndërsa, gjeneralmajor Metin Gurak shprehu kënaqësinë që vizitoi Ministrinë dhe u shpreh se bashkëpunimi i deritanishëm ndërmjet Akademisë Luftarake të Turqisë dhe FSK-së ka qenë i shkëlqyeshëm duke nënvizuar se oficerët e FSK-së të cilët kanë vijuar këtë akademi kanë qenë shumë të suksesshëm. Ai, potencoi gjithashtu faktin se; përveç 450 kadetëve dhe oficerëve që ka kjo akademi, nga stafi vendor, aktualisht në Akademi vijojnë mësimet dhe 80 oficerë nga shumë vendeve të botës, ndër ta edhe nga Kosova.
Ministri Çeku dhe gjenerali Gurak e konfirmuan gatishmërinë për një bashkëpunim edhe më intensiv në të ardhmen. Vlen të theksohet se Ministria e FSK-së, tash e katër vite, ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Ushtrinë e Turqisë, i cili është konkretizuar në shumë fusha dhe është mjaft e theksuar në drejtim të bashkëpunimit dhe mbështetjes për FSK-në.

Ministri i FSK-së priti në takim ministrin e Mbrojtjes së Maqedonisë

Ministri i Mbrojtjes së Maqedonisë, z. Xhaferi konfirmoi gatishmërinë për shkollimin e kadetëve-pilotëve të FSK-së



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, ditë më parë, për një vizitë zyrtare, qëndroi ministri i Mbrojtjes i Ushtrisë së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, i cili u prit me nderime të larta nga Togu Ceremonial i FSK-së.
Ministri Çeku, fillimisht, ka zhvilluar një takim, veçmas, me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë z. Xhaferin, pastaj takimi ka vazhduar në nivel të dy delegacioneve.
Agim Çeku, pasi që falënderoi ministrin e Mbrojtjes së Maqedonisë, z. Xhaferi, foli edhe për bashkëpunimin e mirë në mes të dy vendeve. Në fjalën e tij ai shtoi: "Politika jonë është zhvillimi i marrëdhënieve të mira me shtetet e rajonit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi jemi takuar edhe sot me ministrin e Maqedonisë. Unë, tha ministri Çeku, falënderova ministrin Xhaferi, por edhe e informova për të arriturat e FSK-së dhe për objektivat tona që i kemi për vitin 2013, për ecurinë e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë si dhe sfidat nëpër të cilën po kalojmë. Sa i përket bashkëpunimit dypalësh ne kemi një marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë, marrëveshje e cila na ofron hapësirë dhe mundësi të mëdha për bashkëpunim sidomos në shkollimin e kadetëve tanë. Në rrafshinë ndërkombëtar Maqedonia do të angazhohet për ta ndihmuar FSK-së, që të bëhet pjesë e NATO-s.
Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Republikës së Maqedonisë, Xhaferi shprehu gatishmërinë për ta ndihmuar FSK-në, në të gjitha ato fusha që janë me interes të përbashkët. "Ne, biseduam për vazhdimin e këtij bashkëpunimi dhe njëherësh shpreha gatishmërinë për ta ndihmuar FSK-në, në shkollimin e kadetëve, të pilotëve të ardhshëm si dhe e sigurova ministrin Çeku, se të gjitha ushtrimet që do të mbahen në Republikën e Maqedonisë si në Poligonin Ushtarak në Krivollak, në Qendrën Rajonale për Komunikim, Qendrën e Trajnimit të Pilotëve e të tjera, do të jenë edhe në shërbim të FSK-së.
Ndërsa në konferencën për gazetarë, ministri Çeku potencoi se FSK-ja është në pritje të vendosjes së raporteve formale me NATO-n, ngase Kosova është vendi i vetëm që ende nuk ka raporte formale. Po ashtu jemi në pritje që NATO-ja të merr një vendim që të pranoi rekomandimet e Komandantit të KFOR-it, që FSK-ja i ka arritur kapacitetet e veta operacionale, duke përmbushur misionin e vet, sipas planit të Ahtisarit.

Ambasada e SHBA-ve dhuroi tri automjete për Qendrën Koordinuese të Deminimit të FSK-së



Në emër të SHBA-ve, donacionin prej tri automjetesh, dedikuar Kompanisë së Deminimit, ministrit Agim Çeku ia dorëzoi, ambasadorja e SHBA-ve në Prishtinë,Tracey Jacobson.
Ceremonia e dorëzim-pranimit u mbajt në kazermën e FSK-së "Adem Jashari" në Prishtinë, më 19 prill 2013, në të cilën morën pjesë: komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministri Bejtush Gashi, komandanti i KFT-së gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralbrigade Imri Ilazi e Gëzim Hazrolli, atasheu ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë, koloneli James Kott, si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe Kompanisë së Deminimit. *(vijon në faqen 2)*

Komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati, priti një delegacion të NATO-s



Një delegacion i NATO-s, (16.04.2013) i prirë nga Ms. Mari SKAARE, Ms. Liliane MAES dhe nënkolonel Nichoals THEAKSTON, ka qëndruar për një vizitë pune në FSK, ku u prit nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati.
Fillimisht, gjeneral Kastrati e njoftoi delegacionin e NATO-s për të arriturat e FSK-së, për barazinë gjinore në FSK dhe fushat e bashkëpunimit me NATO-n, KFOR-in dhe me institucionet tjera ndërkombëtare, me mision në Kosovë, të cilat kanë ndihmuar dhe po vazhdojnë të ndihmojnë në avancimet e FSK-së.
Qëllimi i vizitës së delegacionit të NATO-s ishte njoftimi rreth zbatimit të Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria"të OKB-së, për FSK-në, si dhe barazia gjinore në FSK dhe bashkëpunimi në mes të KFOR-it dhe FSK-së.
Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, nga delegacioni i NATO-s kërkoi ndihmë për shkollimin e femrave të FSK-së, në shkollat e NATO-s. Ndërsa, Ms. Mari SKAARE, përfaqësuese speciale e NATO-s, për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, duke u shprehur e kënaqur me përqindjen e pjesëmarrjes së femrave në FSK, ajo premtoi se nuk do t'i pushoi përpjekjet e saja për të ndihmuar në drejtim të shkollimit të pjesëtareve të FSK-së.
Delegacioni i NATO-s, po sot, u prit edhe nga komandanti i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama. Fusha e interesimit të këtij delegacioni ishte gjendja e përfaqësimit gjinor në KFT si dhe bashkëpunimi, aktivitetet dhe trajnimet me KFOR-in.

Komandanti i FSK-se gjeneral Kastrati dhe zëvendësministri Gashi bënë homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Koshare

Në 14- vjetorin e Betejës së lavdishme të Koshares, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me zëvendësministrin e FSK-së Bejtush Gashin dhe gjeneralët: Gëzim Hazrollin e Enver Cikaqin, në kuadër të manifestimit "Ditët e Shqipes" dhe në shenjë nderimi dhe respekti për veprën dhe sakrificën e të rënëve në Luftën për Çlirimin e Kosovës, bënë homazhe dhe vendosen lule të freskëta në Varrezat e Dëshmorëve të Brigadës 138 "Agim Ramadani" të UÇK-së, në Koshare.

Zëvendësministri Veseli priti përfaqësuesin e GIZ-it, z. Robbe

Shemsi Veseli, zëvendësministër i FSK-së, priti në një takim pune ish-komisionarin për Forcat e Armatosura të Bundestagut Gjerman, Reinhold Robbe, ekspert për siguri në GIZ (Bashkëpunimin Ndërkombëtar Gjerman). Në takim u diskutua për Projektligjin për Komisionin për Mbikëqyrje të Kuvendit të Kosovës, për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Policinë e Kosovës.
"Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë drejtim dhe e kemi forcuar jashtëzakonisht bashkëpunimin në fushën e sigurisë, tha në fillim zëvendësministri Veseli, për të shtuar se; ky projektligj do të ndikojë pozitivisht në kontrollin demokratik dhe në mbrojtjen e të drejtave njerëzore, sidomos, për pjesëtarët e uniformuar.
FSK-ja në këtë drejtim u kushton rëndësi të madhe të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve të të dy gjinive. Ndërsa, eksperti për siguri nga Gjermania, Reinhold Robbe tha se ky projektligj është shumë i rëndësishëm për FSK-në dhe me këtë projektligj do të rritet reputacioni i Kosovës dhe, se, këtë projektligj nuk e kanë të gjitha vendet tjera. "Dua të theksoj se ky është projekti i parë që përkrahet nga Ministria për Zhvillim e Gjermanisë dhe dua të theksoj se është hera e parë që përfaqësues të parlamentit, ministrive dhe institucioneve tjera, bëjnë një punë kaq të mirë, me një bashkëpunim të jashtëzakonshëm" përfundoi Robbe.



Ambasada e SHBA-ve dhuroi tri automjete për Qendrën Koordinuese të Deminimit të FSK-së



(Vijon nga faqja 1)
Ministri Agim Çeku ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ambasadoren Tracey Jocobson, për ndihmën që po japin për Kosovën dhe FSK-në.
Kjo ndihmë për FSK-në është shumë e rëndësishme, sepse me këto automjete ne po i rrisim kapacitetet e çminimit, kur dihet se mjetet e pashpërthyera në Kosovë ende paraqesin rrezik të madh për qytetarët e Kosovës. Faktet dëshmojnë se si pasojë e minave dhe mjeteve të tjera të pashpërthyera, kanë humbur jetën mbi 115 qytetarë dhe mbi 400 të tjerë kanë pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja për tërë jetën. Kompania e Deminimit ka hulumtuar mbi 700.000m^2 dhe kjo dëshmon më së miri për punën profesionale të deminerëve, të cilët kanë shkatërruar mbi 835 mjete të pashpërthyera. Dy ekipet e EOD-s, të cilat qëndrojnë kujdestare 24 orë gjatë 7 ditëve kanë intervenuar mbi 774 raste dhe kanë shkatërruar mbi 1440 mjete të pashpërthyera.
Me këtë po dëshmojmë se FSK-ja ka ndërtuar kapacitete profesionale të deminimit dhe jemi të gatshëm të marrim pjesë kudo në misione paqeruajtëse në botë.
Ndërsa, ambasadorja e SHBA-ve, Tracey Jocobson, në fjalën e saj, tha: SHBA është krenare që po e mbështet FSK-në me automjete të cilat do të ndihmojnë në sigurimin e jetës së të gjithë qytetarëve të Kosovës, kur dihet se në Kosovë ka shumë fusha të minuara që ende nuk janë zbuluar dhe paraqesin rrezik të madh për qytetarët e saj. Unë jam e bindur se këto automjete do të jenë në shërbim 24 orë për EOD-n dhe do të shërbejnë për të gjithë qytetarët e Kosovës.
Ambasadorja Jocobson përshëndeti edhe angazhimin e Ahmet Sallovës, përgjegjës i Zyrës për Deminim në MFSK, për të shtuar, më pas, se vet Logot në këto automjete janë dëshmi e partneritetit të përbashkët.

Nënshkruhet marrëveshja për pranimin e donacionit në vlerë prej 160.000 dollarësh



Në ambientet e Ministrisë së FSK-së, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj dhe zyrtari i Ambasadës amerikanë në Prishtinë, Michael Kreidler, zyrtarisht nënshkruan marrëveshjen për pranimin e donacionit në vlerë prej 160.000 dollarësh, tri automjete të tipit Ford Ranger, për Qendrën Koordinuese të Deminimit (QKD) të MFSK-së.
Ambasada e Amerikës në Prishtinë, përmes Zyrës së Departamentit të Shtetit për Largimin dhe Pakësimin e Armëve po e ndihmon FSK-në, përmes këtyre automjeteve. Kjo është edhe një ndihmë e vazhdueshme e SHBA-ve për FSK-në.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Operacioni i deminimit në Parkun e Gërmisë po kryhet nga FSK-ja, me mbështetjen e Forcave të Armatosura Suedeze



Projekti pritet të përfundojë në fund të qershorit të vitit 2013. Pas realizimit të këtij projekti, popullsia vendore, vizitorët dhe përfituesit tjerë do të mund të lëvizin lirisht në këtë zonë pa u frikësuar se do të lëndohen nga minat/mjetet e pashpërthyera.
Regjimenti i Xhenios "Göta "i ka vënë në dispozicion ekskavatorët e blinduar që mund të dirigjohen nga largësia, për të gërmuar ndërtesat, ndërsa FSK-ja e ka vënë në dispozicion personelin për deminim. Shtatë ushtarë suedezë të Kompanisë së Deminimit të Regjimentit të Xhenios "Göta" po e mbështesin këtë projekt.
Pastrimi i mjeteve të pashpërthyera në Parkun e Gërmisë është iniciativë e Qendrës Koordinuese për Deminim, që ka filluar në vitin 2011. Shtrirja e projektit vlerësohet të jetë rreth 30.000 m^2.
Gjatë bombardimeve të NATO-s janë bombarduar dhe rrënuar ndërtesat në Parkun e Gërmisë që atëherë i kishte zënë policia serbe. Ka akoma mjete të pashpërthyera dhe toka nuk shfrytëzohet për shkak të rrezikut nga bombat kasetë që kanë mbetur nën gërmadha.

Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Suedisë



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, (MFSK) u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Suedisë, për trajnimin e FSK-së, për operacionet e Deminimit në Kosovë.
Memorandumin në emër të FSK-së e nënshkroi gjeneral brigade Imri Ilazi-shef i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve në FSK, ndërsa në emër të Forcave të Armatosura të Suedisë, kolonel Michael Kristoffersson- komandant i JRD-C (Komandant i Kontingjentit të KFOR-it Suedez).

Ambasadorja Jacobson dhe komandanti i FSK-së qëndruan për një vizitë pune në KDS



Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Tracey Jacobson, së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin, kanë qëndruar për një vizitë pune në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, ku u pritën nga komandanti i saj, gjeneral-brigade, Enver Cikaqi, me bashkëpunëtorë.

Gjeneral Kastrati e njoftoi ambasadoren e SHBA-ve me të arriturat e përgjithshme të FSK-së dhe njëherësh e falënderoi për ndihmën e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës po japin për FSK-në dhe Kosovën. Ndërsa, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi e njoftoi ambasadoren për zhvillimet dhe punën që po kryhet në KDS-së, për bashkëpunimin me forcat ndërkombëtare, si dhe për sfidat dhe objektivat e KDS-së.
Ambasadorja Jacobson së bashku me gjeneral Kastratin dhe gjeneral Cikaqin vizituan Qendrën për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve, ku u takuan me pjesëmarrësit e Kursit të Avancuar të Nënoficerëve dhe ata të Kursit të Gjuhës Angleze.
Ambasadorja amerikane, duke u shprehur në gjuhën shqipe përshëndeti pjesëmarrësit e këtyre kurseve dhe ju dëshiroi suksese në të ardhmen.
Në fund, ambasadorja Jacobson vizitoi rekrutët e Kursit Bazik të Rezervës Aktive dhe pas një bisede për të arriturat e FSK-së, iu përgjigj edhe pyetjeve të rekrutëve, që kishin të bënin me të ardhmen e FSK-së.

FSK-ja po dëshmon se është një forcë e besueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës

Në Ministrinë e FSK-së, më 30.04.2013, u organizua takim informues me ambasadorë dhe atashetë ushtarak të akreditуar në Prishtinë, ku morën pjesë edhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, përfaqësues të komunave të banuara kryesisht nga komunitete pakicë dhe të shoqërisë civile.

Fillimisht të pranishmit i përshëndeti zëvendësministri Shemsi Veseli, i cili theksoi se; qëllimi i këtij takimi është raportimi i të arriturave të FSK-së, për ambasadorët, organizatat joqeveritare, përfaqësues të komunave të banuara me shumicë nga komunitetet pakicë dhe shoqërisë civile.
Ministri i FSK-së, Agim Çeku, tha se: ky bashkëpunim ka një rëndësi të shumëfishtë për ne, sepse ne jemi shumë të hapur me të gjithë, e sidomos jemi shumë transparent edhe me organizata joqeveritare, të cilët i informojmë në mënyrë të rregullt me të arriturat e FSK-së.
Bashkëpunimi i përgjithshëm jo vetëm me ambasadorët e akreditуar në Kosovë, por edhe me shoqëritë civile, tregon për një nivel demokratik të FSK-së.
Para pjesëmarrësve u bë një prezantim i të arriturave të përgjithshme, nga fushat më të rëndësishme, të veprimtarisë së Ministrisë dhe FSK-së. Për temën, Mbështetja e objektivave të Ministrit për vitin 2013 dhe për arritjet e përgjithshme të FSK-së, të pranishmit i njoftoi nënkolonel Haki Hoti, ndërsa, drejtori i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, Ibrahim Shala, prezantoi materialin Informimi publik dhe transparenca në MFSK dhe FSK. Për angazhimin e komuniteteve pakicë, në MFSK dhe FSK, foli Azemina Qullum, shefe e Zyrës për Komunitete e cila i njoftoi të pranishmit për përqindjen e komuniteteve në FSK-së, duke konstatuar se 8.2% e pjesëtarëve janë nga radhët e komuniteteve. Për Bashkëpunimin Civil-Ushtarak dhe për realizimin e të gjitha projekteve nga FSK-ja, në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës, të pranishmit i njoftoi Agron Durmishi, zyrtar i këtij departamenti.
Në fund të prezantimeve, pjesëmarrësit bënë komente dhe pyetje për pjesëmarrjen e komuniteteve në FSK dhe për besueshmërinë që kanë qytetarët e Kosovës për FSK-në.



Ndërsa, ministri i FSK-së, Agim Çeku, pasi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit u ndërlidhë me përgjigje në pyetjet e shumta që kishin të bënin sidomos me pjesëmarrjen e komuniteteve në radhët e FSK-së.
Ministri Çeku, tha se, nuk jemi komod edhe përkundër vlerësimeve të shkëlqyeshme nga sondazhet e opinionit të qytetarëve për FSK-së, ne vazhdojmë të punojmë vazhdimisht në ngritjen e FSK-së, vazhdojmë t'i ndihmojmë të gjithë qytetarët në realizimin e të gjitha projekteve që janë në interes të tyre.
Ne, me angazhim maksimal e ngritëm imazhin e FSK-së dhe jemi duke vepruar mirë që të jemi forcë e vlefshme për të gjithë qytetarët e Kosovës.
Rritja e pjesëmarrjes së pjesëtarëve të minoriteteve në FSK , për ne, është një sfidë në vazhdim. Po angazhohemi fuqishëm që të gjithë pjesëtarët e komuniteteve të jenë të barabartë dhe të ndjehen mirë, sepse ne po ndërtojmë një forcë të besueshme për të gjithë qytetarët e saj.

Intervistë me komandantin e KDS-së, gjeneralbrigade Enver Cikaqi

Objektivi i KDS-së në të ardhmen është ngritja e kapaciteteve të plota



"Forca Jonë": *Për fillim, z. komandant, një përshkrim të shkurtër për KDS-në?Cila në të vërtetë është KDS-ja?!.*

Gjeneral Cikaqi: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, është njëra prej njësive të Komandës së Forcës së Sigurisë dhe është përgjegjëse të drejtojë stërvitje themelore, të specializuara, të udhëhecjes dhe stërvitjes kolektive për personelin aktiv dhe rezervë të FSK-së. Në bashkëpunim dhe bashkërendim me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Komandën e Forcave Tokësore (KFT) dhe Ekipin Mentorues të NATO-së, zhvillon doktrinën, dokumentet dhe rregulloret themelore dhe përfundimtare, programet e trajnimit si dhe mirëmban Arkivin e Doktrinës dhe Botimeve.

"Forca Jonë": *Si lindi dhe u zhvillua KDS -ja?*

Gjeneral Cikaqi: Arti Luftarak ekziston qysh nga luftërat e hershme në histori. Edhe ne kemi artin luftarak të trashëguar, ku nuk duhet lënë pa përmendur luftërat e suksesshme me numër shumë të vogël të ushtarëve të Skënderbeut, periudhën e lavdishme të Lidhjes së Prizrenit. Gjatë gjithë këtyre luftërave ka ekzistuar një edukim dhe sistem i shkollimit ushtarak. Po ashtu edhe gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u krijuan Qendra të Stërvitjes në shumë Zona të luftës, u krijua Akademia e Mbrojtjes ,,HAMËZ JASHARI", e cila vazhdoi veprimtarinë edhe pas luftës, e më pas edhe Komanda e Stërvitjes dhe Doktrinës e TMK-së e cila vazhdoi trajnimin e pjesëtarëve të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës.

Pas përfundimit të misionit të TMK-së dhe ristrukturimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si rrjedhojë e proceseve, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes ka filluar punën me 21 janar 2009. Ne kemi shfrytëzuar punën e paraardhësve tanë në TMK, megjithatë, fillimisht kemi pas sfida si në aspektin e infrastrukturës, po ashtu edhe të kuadrit profesional, që nënkupton se është dashur që të përgatisim instruktorët tanë fillimisht e mandej kemi marrë detyrat të cilat i përcakton misioni i KDS-së. Pra, detyrë e jona është t'i stërvitim të gjithë pjesëtarët e FSK-së, duke filluar nga niveli bazik e deri në atë profesional të zhvillimit të karrierës.

"Forca Jonë": *KDS-ja realizon programin për stërvitje dhe shkollim profesional, me kritere të shkollimit sipas standardeve të NATO-s, si një force profesionale me shërbim vullnetar, cila është struktura e KDS-së, ?*

Gjeneral Cikaqi: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes në strukturën e saj, ka: Shtabin, Sektorin e Doktrinës, Kompaninë Mbështetëse dhe pesë shkolla (Qendra të Stërvitjes): Qendra e Stërvitjes Bazike, Qendra e Stërvitjeve Specialistike, Qendra e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve, Qendra e Studimeve Universitare dhe Qendra e Stërvitjes Kolektive. Të gjitha trajnimet realizohen në këto shkolla të cilat i cekëm, ndërsa programet e trajnimeve janë të standardizuara sipas kritereve të NATO-s.

Në kuadër të Doktrinës kemi personelin i cili merret me standardizimin e dokumentacionit dhe kjo ka bërë që, ne sot, të kemi dokumentacionin unik të standardizuar jo vetëm në KDS, por në të gjitha njësitë e FSK-së.

"Forca Jonë": *Në kuadër të KDS funksionojnë Qendra e Stërvitjes Bazike (QSB), Qendra e Stërvitjes Specialistike (QSS), Qendra e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve (QZHPU), Qendra e Studimeve Universitare (QSU) dhe Qendra e Stërvitjes Kolektive (QSK). Gjeneral cilat janë rezultatet që ka arritur KDS-ja,?*

Gjeneral Cikaqi: Ne e dimë rolin e NATO-s në ngritjen e FSK-së. Në këtë mënyrë, në vitin 2009 u krijua një Ekip i cili u quajt Ekipi i NATO-s për trajnim (ENT), i cili përbëhej nga oficerë, nënoficerë në cilësinë e instruktorëve nga shumë vende që janë pjesë e NATO-s. Fillimisht ekip ekzekutoi programin bazik për të gjithë pjesëtarët e FSK-së , i cili ka qenë kusht për të kaluar në nivelet tjera më të avancuara. Pastaj vazhduam me programin për instruktorë të FSK-së dhe programe të stërvitjeve specialistike. Bartja e kompetencave të ekzekutimit të programeve të stërvitjeve nga Ekipi i NATO-s për trajnim tek KDS është bërë gradualisht. Si rrjedhojë, kemi filluar me një program të



stërvitjes në 2009, sot, falë punës së shkollave tona dhe Stafit të KDS dhe me ndihmën e Ekipit të Mentorëve dhe ekipeve mobile të vendeve mike, si: ekipeve amerikane, angleze, turke, gjermane, etj, ne kemi 36 programe të stërvitjes në KDS. Pra, sot instruktorët tanë janë duke bërë punën të cilën në fillim e kryente Ekipi i NATO-s. Qëllimi jonë është implementimi i Konceptit të Edukimit të ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së.

Pas përfundimit të Stërvitjes bazike, varësisht prej njësive pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së kanë ndjekur trajnime të veçanta (specialistike) nga fusha të ndryshme, në nivel më të avancuar. Në këtë drejtim pothuajse secili pjesëtar ka kryer nga një e më tepër trajnime. Në Qendrën e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve janë realizuar trajnime të ndryshme si ato të: nënoficerëve, Kursi bazik për oficer, Kursi i avancuar i oficerit, Kursi i liderit kryesor, Kursi i liderit luftarak, etj,. Në këto kurse kanë dhënë kontribut të madh profesional ekipet amerikane dhe angleze. Po ashtu, në kuadër të QZHPU kemi edhe laboratorë të gjuhëve të huaja, që deri më tani janë mbajtur kurset e gjuhës angleze dhe gjuhës turke, e që në të ardhmen presim që të kemi kurse edhe të gjuhëve tjera.

Qendra e Studimeve Universitare në programin e saj ka ngritjen profesionale të kadetëve të cilët vijnë nga shoqëria civile dhe ju nënshtrohen rregullave ushtarake. E veçanta e kësaj Qendre është se kadetët gjatë studimeve ndjekin dy programe njëkohësisht, atë ushtarak që realizohet në QSU dhe studimet të cilat realizohen në Universitetin Amerikan, e që pas përfundimit të studimeve, të gjithë ata që kryejnë studimet me sukses gradohen dhe dalin në detyrë me gradën e nëntogerit.

Qendra e Stërvitjes Kolektive në misionin e saj ka organizimin e trajnimeve kolektive, e që ne i shfrytëzojmë dhe përdorim për trajnimet fushore, trajnimet e simuluara etj,. Në QSK kanë dhënë një kontribut të madh instruktorët mentorues italian, të cilat kanë bërë një punë të palodhur. Në këtë Qendër aktualisht organizohen trajnime në nivel togu, kompanie, batalioni e deri në nivel brigade.

Angazhimi i pjesëtarëve prej fillimit ka qenë i lartë dhe kjo ka bërë që të kemi rezultate me të cilat sot ne mburremi.

"Forca Jonë": *Cili është kuadri i KDS-së, dhe çfarë presim në këtë drejtim në të ardhme?*

Gjeneral Cikaqi: Deri sa folëm veç e veç për të gjitha qendrat e trajnimit ne sqaruam se si realizohen trajnimet, në çfarë niveli dhe cilat janë të arriturat tona deri më tani. Pa një kuadër profesional nuk mund të realizohen të gjitha këto trajnime. Mirëpo, edhe në anën tjetër duhet të kemi parasysh se për dallim nga viti 2009, kur ne patëm filluar me trajnimet themelore, kemi avancuar larg me trajnime të ndryshme. Megjithatë, konsideroj se kemi instruktorë të përgatitur në aspektin profesional, të trajnuar brenda dhe jashtë shtetit, por edhe një gjë të them se instruktori gjithherë duhet të jetë aktiv, duhet të rifreskoi dhe avancoi pjesën që e ka në përgjegjësi , me çka unë jam i kënaqur me angazhimin e tyre. Me përkushtimin që e tregojnë instruktorët tanë, me besim të plotë them se KDS-ja ka të ardhme të sigurt, dhe përgatitje profesionale të kuadrit.

"Forca Jonë": *Çfarë mund të na thoni për bashkëpunimin tuaj me KFOR-in dhe me të tjerët në përgjithësi?*

Gjeneral Cikaqi: Bashkëpunimi me KFOR-in ka qenë dhe është i shkëlqyeshëm dhe vazhdojmë këtë bashkëpunim në hartimin e dokumenteve doktrinare dhe në identifikimin e kurseve të avancuara duke u bazuar në misionin që e kemi ne si FSK. Që nga viti 2009 KDS ka pas një bashkëpunim të shkëlqyer me Ekipin e NATO-s që është i dislokuar në KDS. Stafi i KDS çdo herë koordinon dhe bashkërendon të gjitha aktivitet në fazën e planifikimit, në fazën e ekzekutimit dhe në analizat e pas veprimit të aktiviteteve stërvitore. Krejt ky suksesi yni vlerësoj se është rezultat i bazamentit të trashëguar, i bashkëpunimit shumë të ngushtë me instruktorët, e më vonë të mentoruesit të KFOR-it, bashkëpunimit të ngushtë me KDS-në simotër të Ushtrisë së Republikës së Shqipërisë, të ekspertëve ushtarak amerikan, anglez, gjerman, e vendeve tjera, bashkëpunimit të ngushtë në ushtrime në Shqipëri, Holandë, Gjermani dhe Maqedoni. Një bashkëpunim të veçantë e kemi edhe me Grupin Luftarakë të Lindjes -Kampin Bonstill. Komandanti i Kampit Bonstill, koloneli Black Storey ka qenë disa herë në vizitë dhe ka dërguar ekipet e veta trajnuese në KDS. Instruktorët amerikanë vazhdojnë të japin ndihmë në realizimin të shumë programeve stërvitore avancuese të cilat ndikojnë në ngritjen opracionale të FSK-së .

"Forca Jonë": *Z Gjeneral, cili është objektivi i KDS për të ardhmen?*

Gjeneral Cikaqi: KDS si Qendër e Ekselencës që është, në të ardhmen ka për objektiv ngritjen e kapaciteteve të plota për të realizuar suksesshëm misionin tonë. Të arrijmë të realizojmë objektivin e KOMFT-së, KOMFSK-së dhe Ministrit të FSK-së për të krijuar një sistem të mirëfilltë të edukimit edhe stërvitjes. Realizimi i Konceptit zhvillimor të edukimit do të jetë një e arritur e jona e radhës që do të na ndihmon që përfundimisht të vendosim Standardin e stërvitjes dhe edukimit për të gjithë ushtarakët e FSK-së.



Certifikohen 151 pjesëtarë të Komponentit Rezervë

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, pas një trajnimi pesëjavësh, u bë certifikimi i 151 pjesëtarëve të Komponentit Rezervë të FSK-së, Gjenerata e Parë, për vitin 2013, në Kursin Bazik. Në ceremoni morën pjesë; gjeneralmajor Rrahman Rama, komandant i KFT-së, komandant i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, atasheu ushtarak nga Ambasada amerikane në Kosovë, koloneli Kott.

Gjeneral Rama i ka përgëzuar rekrutët e Komponentit Rezervë të FSK-së, për përfundimin me sukses të këtij kursi. Ai përshëndeti edhe familjarët e rekrutëve që ishin të pranishëm në ceremoni. Rekrutët e rinj i përshëndeti edhe atasheu ushtarak amerikan, koloneli Kott.

Në fund për arritjen e rezultateve të mira u shpërblyen 10 pjesëtarë të këtij komponenti.





Gjeneral Hazrolli kampion i tetëfishtë i shenjëtarisë në Kosovë

Në çdo luftë, betejat fitohen nga qitës të mirë

Gjenerabrigade Gëzim Hazrolli është zëvendëskomandant i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së. Temë e intervistës sonë, me gjeneralin, është shenjëtaria. Ai me këtë sport filloi të merret shumë herët, qysh gjatë kohës sa ishte kadet, në Akademinë Ushtarake në Zagreb. Edhe pas përfundimit të luftës, Gjeneral Hazrolli sportit të shenjëtarisë i është përkushtuar shumë, ai ka arrit që të bëhet kampion i tetëfishtë i shenjëtarisë në Kosovë. Gjeneral Hazrolli ka marrë pjesë në shumë gara të zhvilluara në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni,etj, dhe ka fituar dhjetëra medalje, diploma dhe mirënjohje. Gjeneral Hazrolli është eksperti i vetëm i kësaj fushe i cili ka mbrojtur temën e Masterit, në këtë lami, me titullin: "Ndikimi i disa parametrave motorik dhe konativ në shenjëtari".

"Forca jonë": *Zotëri gjeneral çka mund të na thoni për historikun e këtij sporti në përgjithësi?*


Gjeneral Hazrolli: Shenjëtaria është ndër sportet më të vjetra olimpike në botë, ndërsa te ne, shqiptarët, sipas traditës së lashtë, thuhej, se: ,,Në çdo gazmend apo festë fetare-familjare qitej në shenjë, bile, pa u "vra shenja" nuk i dorëzohej as nusja mikut ." (Ali Pllana), këtë desha ta ndërlidhë se shenjëtaria është zhvilluar që në kohë të vjetra dhe e ka përcjellë popullin tonë me vite. Fillet e shenjëtarisë në Botë, i gjejmë në Zvicër, qysh në vitin 1466, organizuar në shoqatën e parë, në qytetin Lucern, ndërsa në shekulli e XVI hapen poligonet e para të shenjëtarisë në Pragë, në Salzburg, etj. Në shekullin e XVIII, paraqiten shoqata dhe shoqëri me rregulla të caktuara, ndërsa në shekullin XIX dhe në fillim të shekulli XX, shenjëtaria ndahet në disiplina. Në Kosovë, për herë të parë shoqatat e shenjëtarisë u formuan në vitin 1929 në Prishtinë, Mitrovicë dhe Pejë, ku njëheritë, janë mbajtur edhe garat e para të shenjëtarisë sportive.

Më vitin 1936, në Prishtinë ngrihet poligoni i parë, më 8 vende për gjuajtje, ndërsa më 26 mars të vitit 1946, po, në Prishtinë, formohet Këshilli i sportit të shenjëtarisë, ku kryetar i parë ishte Ramadan Vraniqi, (sporti i shenjëtarisë në Kosovë, nuk e kishte mbështetjen si në pjesët tjera të ish-Jugosllavisë, edhe pse shenjëtarët shqiptarë, në atë kohë, ishin kampionë të shumëfishtë, ata ishin të diskriminuar, vetëm pse ishin shqiptarë, dhe për këtë, kurë nuk i thirrën ta mbronin kombëtaren e Jugosllavisë, në gara ndërkombëtare, në shenjëtari)



Gjatë vitit 1958 numri i shoqatave të shenjëtarisë në Kosovë, arrin në 223, ndërsa pas vitit 1978, kemi rënie të numrit të shoqatave, por në të njëjtën kohë, shenjëtaria shënon ngritje të cilësisë. Këtë desha ta ndërlidhi, se shenjëtarët e Kosovës në kampionatet e Jugosllavisë, kishin fituar 8 medalje të arta, 13 të argjendta dhe 14 të bronzit, që ishte një sukses jashtëzakonisht i mirë. Shenjëtarët e Kosovës u dalluan edhe në lojërat Mesdhetare dhe në Kampionatin Ballkanik. Shenjëtarët më të dalluar të asaj kohe, ishin; Ali Pllana, Sanije Hyseni, Nebih Ahmeti, Muhamet Humolli, Gazmend e Behlul Beqaj, Ilaz Blaku etj .

"Forca jonë": *Po ju, kurrë keni filluar të merreni me sportin e shenjëtarisë?*



Gjeneral Hazrolli: Unë aktivitetin si shenjëtarë e kam filluar në shkollën e mesme, Akademinë Ushtarake në Zagreb, vitet 80-ta, si amator dhe në mënyrë aktive kam vazhduar pas përfundimit të luftës në Kosovë, më 1999, dhe që nga atëherë kam marrë pjesë në shumë gara të shenjëtarisë, të mbajtura në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

"Forca jonë": *Cilat janë problemet kryesore me të cilat përballet shenjëtaria në Kosovë dhe në FSK?*

Gjeneral Hazrolli: Si çdo sport tjetër në Kosovë edhe sporti i shenjëtarisë po përballet me probleme të shumta. Problemi i parë është se Federata e shenjëtarisë së Kosovës, ende nuk është e pranuar në Federatën Botërore të shenjëtarisë dhe ky është më shumë problem politik, i cili besoj se do të zgjidhet së shpejti. Gjithashtu problem në vete është edhe infrastruktura jo e mirë; mungojnë poligonet e qitjes, mungon financimi, kur dihet se ky sport është shumë i kushtueshëm, vetëm pajisjet individuale për një sportist sipas standardeve, për të marrë pjesë në gara, janë shumë të shtrenjta dhe rinisë sonë dhe të tjerëve u kufizohet mundësia e pjesëmarrjes, për shkak të kushtushmërisë së pajisjeve, etj. Ndërsa, sa i përket zhvillimit të këtij sporti, në Forcën e Sigurisë së Kosovës e them me shumë përgjegjësi se ka mundësi të zhvillimit dhe dua të theksoj se shenjëtarët më të mirë të cilët merren me këtë sport, vijnë nga strukturat e policisë dhe ushtrisë dhe mendoj se ne duhet t'i kushtojmë rëndësi infrastrukturës, ku në çdo kazermë të ndërtojmë poligone të gjuajtjes, me armë ajrore, që do të ishte një mundësi shumë e mirë për zhvillimin e këtij sporti në Kosovë dhe angazhimin e rinisë sonë, në këtë sport.

"Forca jonë": *Zotëri gjeneral, sa është numri i pjesëtarëve të FSK-së, që merren me këtë sport dhe cili është niveli i zhvillimit të saj?*

Gjeneral Hazrolli: Ne, në FSK e kemi një plan vjetor të gjuajtjeve me armë zjarri, numri i pjesëtarëve që merren me këtë sport është relativisht i vogël, disa merren me dëshirën e tyre, ka të tjerë, që e kanë "hobi" dhe vlerësoj shumë punën dhe rezultatet e arritura të pjesëtarëve tanë që kanë treguar gjatë këtyre viteve, në shumë gara të organizuara të shenjëtarisë.



"Forca jonë": *Zotëri gjeneral, cilat janë arritjet tuaja personale në gara të mbajtura në Kosovë dhe jashtë Kosovës?*

Gjeneral Hazrolli: Në Kosovë, Federata e shenjëtarisë ka organizuar dhe organizon gara në shënimin e shumë ngjarje të rëndësishme dhe në evenimente të tjera, si për festa shtetërore, etj. Unë që nga paslufta, në çdo garë që organizohen në Kosovë, jam ndër pjesëmarrësit më aktiv dhe njëherit kamë fituar tetë herë titullin e më të mërit në Kosovë, pra, jam kampion i tetëfishtë i shenjëtarisë në Kosovë. Në evenimentin e shenjëtarisë të organizuar në Kosovë, për nderë të shënimit të Pesëvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, kam arritur të realizoj 563 pikë, nga 600 të pikët e mundshme dhe kam fituar vendin e parë. Kam pas nderin të marrë pjesë edhe në shumë gara të organizuar në bashkëpunim me Federatën e Shenjëtarisë së Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë, dhe kam qenë njëri ndër shenjëtarët më të dalluar.



"Forca jonë": *Zotëri gjeneral, Sa jeni të kënaqur me cilësinë e shenjëtarëve tanë të cilët marrin pjesë në gara jashtë Kosovës?*

Gjeneral Hazrolli: Unë jam shumë i kënaqur me rezultatet e arritura të garuesve tanë, si; të gjinisë femërore dhe mashkullore, të cilët kanë arritur norma olimpike ndërkombëtare dhe kanë shkëlqyer në shumë gara, por problemet e cekura më herët janë faktorët që ndikojnë në mos afirmimin e këtij sporti dhe pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare.

"Forca jonë": *Z. Gjeneral, për fund cili është mesazhi juaj?*

Gjeneral Hazrolli: Për të gjithë ata të cilët e duan këtë sport, jo vetëm për pjesëtarët e FSK-së, i këshilloj, duke u bazuar nga përvoja ime shumëvjeçare, të merren me shenjëtari, sepse është shumë rekreativë, ndihmon dhe largon ngarkesat që ka njeriu, është sport relaksues, dhe nga kjo varet shumë edhe qëllimi i shënjestrës, nëse do jeni stabil, i koncentruar dhe i relaksuar do të keni rezultate shumë të mira dhe njëherë po e potencoj, se, "në çdo luftë betejën e fitojnë qitësit e mirë

Isak Curri, karateist i dalluar, mjeshtër 4-Dan, në stilin "Shoto-Kan"



"Isak Curri është Tetar i Policisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës, i cili ka qenë edhe pjesëtar i UÇK-së dhe TMK-së. Ai merret me sportet luftarake, sidomos më shumë e adhuron karatenë, stili Shoto-Kan. Ka fituar titullin; mjeshtër 4 Dan. Isaku ushtron me përkushtim pjesëtarët e policisë së forcës së FSK-së, për përgatitjen e tyre fizike. Ai kryen edhe detyrën e Instruktorit të karatesë, në shumë klube në Kosovë, dhe në këtë drejtim dallohet me përkushtimin e punës profesionale dhe me arritjen e rezultateve të përgjithshme. Isaku ka dashuri të veçantë për uniformën e FSK-së, dhe për këtë ndjehet krenar, dhe me përkushtim i shërben FSK-së, me qëllim të realizimit të detyrave dhe obligimeve që ka, për Kosovën".

Tetar Isak Curri është nga fshati Llugë, komuna e Podujevës, ka kryer shkollën fillore në vendlindje dhe të mesmen në Podujevë, është pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës i cili punon në Policinë e Forcës. Qëllimi i bisedës sonë, janë të arriturat e tij, në sportin e karatesë:

"Dëshira ime për sport me lindi qysh sa isha nxënës në shkollën fillore, në fillim e adhuroja futbollin si çdo i ri në Kosovë. Në vitit 1986, rastësisht e kam përcjellë Rrahimin, djalin e axhës, në një garë të karatesë, dhe prej asaj dite u dashurova shumë në këtë sport, sa më kurrë nuk jam ndarë. Ushtrimet i kam kryer në klubin e karatesë, në Lluzhan. Mësuesi im, ishte Osman Ejupi, mjeshtër i karatesë i cili më ka ndihmuar shumë në formimin tim prej sportisti.

Në moshën 12 vjeçare, viti 1989, kur kam marrë pjesë për herë të parë, në gara, ku rezultatet e para më inkurajuan që shpirtërisht ta dua sportin e karatesë. Nga kjo ditë, kurrë nuk i ndërpreva ushtrimet, deri në vitin 1994, kur policia serbe na e mbylli klubin, kjo, nuk ndodhi vetëm në komunën tonë, por në përgjithësi në tërë Kosovën.

Pas këtij viti, fillova të ushtroj futboll në klubin e Llapit, i cili asaj kohe bënte gara në Ligën e Parë të Kosovës. Në vitin 1997, dhuna fizike në Kosovë, veç kishte marrë përmasa të një gjenocidi, Serbia ndaloi të gjitha aktivitet sportive.

Me fillimin e luftës, unë së bashku me shumë shokë, kyçem në Brigadën 151" Zahir Pajaziti"

Pas luftës kam filluar ushtrimet në Klubin e Karatesë "Kosovari" në Prishtinë dhe në Klubin Llapi në Podujevë, ndërsa në vitin 2000, së bashku me shumë shokë, kemi riaktivizua Klubin e karatesë "Besa" në Lluzhanë, ku jam emëruar trajner i klubit dhe këtë detyrë e kam kryer me përgjegjësi të plotë, deri më sot.

Në vitin 1989-2002, kam fituar titullin Mjeshtër i shkallës së Dytë, (2-Dan), po ashtu e kam fituar edhe titullin e gjyqtarit kombëtar, në Kosovë, ndërsa në vitin 2009, në Federatën Botërore WTKA jam licencuar gjyqtar ndërkombëtar, për karate.



Pas luftës kam shërbyer në Gardën e Zonës së Pestë të TMK-së, dhe në Gardën e Kosovës. Në FSK, punojë në Policinë e Forcës të FSK-së dhe në të njëjtën kohë, jam instruktor i Policisë së Forcës, për përgatitje fizike.

Pas luftës, kam riaktivizuar Klubin e karatesë "Besa" në Lluzhanë, në të cilin klub po ushtrojnë shumë të rinj. Kurse në vitin 2004 kam hapur Klubin e karatesë në Prishtinë, "Bardhoshi", ndërsa në vitin 2012, kam hapur edhe dy klube tjera; një në Fushë-Kosovë dhe në Obiliq, ku në këto dy klube ushtrojnë shumë të rinj, nga të cilët nesër pres që të bëhen karateistë të dalluar, jo vetëm në Kosovë!.

Klubi më i suksesshëm jo vetëm në nivelin komunal, por edhe në nivel të Kosovës, është padyshim Klubi "Besa" i shpallur edhe nga Kuvendi i komunës së Podujevës, për tri vite; 2004, 2005 dhe 2006, më i miri. Isaku, po ashtu është shpallur trajneri dhe punëtori më i mirë në komunën e Podujevës.

Në Kampionatin Botëror në WTKA, (Federata Transionale Botërore e Karatesë), të mbajtur në Itali, më 2009, 2010, 2011,kam marrë pjesë së bashku me shumë kadetë të mi, ku vendin e parë më 2009 e kanë zënë Qamil Zeka, luftë-kadetë dhe Gresa Zhitia, janë shpallur, në dy disiplina, kampione e botës, ndërsa në disiplinën e luftërave më 2011, janë shpallur kampion bote, edhe Fisnik Rama, Durim Haziri, Pajtim Abazi, Adelina Rama, Diellza Dragusha dhe Agush Nazifi, ky i fundit është pjesëtarë i FSK-së, shërben në BRSH. Kjo është një fitore e madhe për klubin tonë dhe për Kosovën në përgjithësi, pasi për çdo medalje të Arit-vendi i parë, është bërë intonimi i Himni shtetëror të Kosovës.

Klubi i karatesë "Bardhoshi" për momentin është ndër klubet më të mira në Rajon. Me pranimin e federatës sonë në Federatën Botërore, shpresojë se garuesit tanë, do të sjellin medalje në gara ndërkombëtare. Klubi im ka nxjerrë shumë kampion të Kosovës dhe shumë kampion në turne ndërkombëtare që kanë marrë pjesë në gara dhe më gjerë, si në Gjermani, Poloni, Zvicër, Itali, Maqedoni, Mal të Zi, etj.

Në FSK-së ka edhe shumë karateistë të dalluar dhe të cilët kanë fituar tituj si në garat vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, siç janë: Agush Nazifi, Gentiana Kurpuzi, Alban Bylykbashi, Elmira Statovci, Getoar Rexhepi, Valon Halimi, Valoni është edhe trajner i klubit "Fudachi" dhe gjyqtar i karatesë, ka edhe shumë e shumë pjesëtarë të tjerë të FSK-së, që merren me këtë sport luftarak.

Në fund, tetar Curri i fton të gjithë të rinjtë e Kosovës, që të merren me sportin e karatesë, sepse sporti i karatesë është sport fisnik, sport që tregon karakterin, tregon guximin dhe që aftësitë e tyre t'i vënë në shërbim të atdheut.



Konferencë shkencore"Barazia dhe perspektiva gjinore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë"



Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), Bejtush Gashi ishte pjesëmarrës dhe ligjërues në Konferencën shkencore ndërkombëtare "Barazia dhe perspektiva gjinore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë" e cila u mbajt në Shkup të Republikës së Maqedonisë, më 23-24 prill 2013.
Në këtë Konferencë, ku ishte i pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, zv.ministri Bejtush Gashi mbajti një ligjëratë me temë " Barazia dhe perspektiva gjinore në Forcën e Sigurisë së Kosovës". Ai në fjalën e tij tha se Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në mënyre efektive ka integruar Rezolutën 1325 gjatë përmbushjes së rolit dhe obligimeve të veta si në nivel administrativ ashtu edhe në atë operativ.
Zëvendësministri Gashi, më tej, shtoi se Ministria ka hartuar dokumente të veçanta të "Politikës për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore në MFSK dhe FSK" , të cilat ofrojnë udhëzime efektive, të bashkërenduara dhe të qëndrueshme për respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Gashi po ashtu ka përmendur pozitën dhe rolin e femrës në MFSK dhe FSK, si edhe pozitën e minoritarëve në FSK.
Zëvendësministri Bejtush Gashi para të pranishmëve në Konferencë tha gjithashtu se; FSK-ja reflekton një ambient të përshtatshëm dhe një sistem të vlerave ku femrat-pjesëtare të FSK-së trajtohen me dinjitet dhe kanë mundësi të barabarta.
Konferenca shkencore "Barazia dhe perspektiva gjinore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", u mbajt me organizim të Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë në bashkëpunim me Organizatën e Grave të OKB-së dhe Institutin e Mbrojtjes për Siguri dhe Paqe në Shkup.

FSK-ja organizoi pritje për pjesëtarët e saj, të komunitetit turk



Ministri i FSK-së, Agim Çeku, së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastratin dhe komandantin e Komandës së Forcave Tokësore(KFT) të FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Ramen, për nderë të" Ditës së Komunitetit Turk", më 23 prill,
në ambientet e KFT-së, organizuan pritje për pjesëtarët e komunitetit turk në radhët e FSK-së.
Në pritjen e organizuar për pjesëtarët e FSK-së, nga radhët e komunitetit turk, mori pjesë edhe ambasadorja e Republikës së Turqisë në Kosovë, Sangul Ozani, ministri i Administratës Publike në Qeverinë e Kosovës, Mahir Jagxhillar, deputetja e Kuvendit të Kosovës, Musera Sinik si edhe zëvendësministra dhe qeveritarë të tjerë me përkatësi turke.
Pritja e sotme shënoi një formë të re të angazhimit të Ministrisë dhe FSK-së, drejt vlerësimit konkret, si edhe një kujdes dhe respekt për pjesëtarët e FSK-së nga ky komunitet, të cilët janë pjesë aktive dhe kontribuues në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së.
Pjesëtarët e komunitetit turk u shprehen të kënaqur me punën në FSK, si dhe vlerësuan lartë pritjen që u organizua për nderë të tyre.
Ata po ashtu shprehën vullnetin e tyre të vazhdueshëm që të kontribuojnë në ngritjen e FSK-së dhe zhvillimin e Kosovës në përgjithësi.

FSK-ja shënoi “Ditën e Tokës” me mbjelljen e fidanëve në fshatin Malishevë të Gjilanit

Ministri Agim Çeku, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, në fshatin Malishevë të Komunës së Gjilanit, në mënyrë simbolike, filluan aksionin e mbjelljes së fidanëve nga pjesëtarët e FSK-së, me rastin e 22 prillit "Ditës së Tokës".
Ministri Agim Çeku, me rastin e fillimit të aksionit për shënimin e "Ditës së Tokës", tha: "Kujdesi për mjedisin është përgjegjësia jonë e përbashkët. Te gjithë të jemi aktiv në mbrojtjen dhe kujdesin për mjedisin tonë. Ndërgjegjësimi për mjedisin të bëhet pjesë e sjelljes tonë, të menduarit dhe veprimi ynë miqësor ndaj mjedisit janë detyra jonë e përbashkët që të përmirësojmë kualitetin e ambientit në të cilin jetojmë dhe punojmë. Edhe mbjellja e pemëve sot është njëra nga mënyrat për ta bërë ambientin më cilësorë. Në të njëjtën kohë, mbjellja e pemëve mbart një domethënie simbolike-ne i mbjellim, ato rriten dhe na bashkojnë me brezat që vijnë".
Në aksionin për mbjelljen e fidanëve morën pjesë 100 pjesëtarë të FSK-së, rreth 15 pjesëtarë të kontingjentit amerikan të KFOR-it, nxënës të shkollave të mesme të Malishevës dhe Gjilanit, si edhe qytetarë të tjerë të komunitetit. Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunim me Agjensionin e Kosovës për Menaxhimin e Pyjeve.
Gjatë aksionit të sotëm u mbollën mbi 300 fidane të reja, pisha halore, me të cilat u pyllëzuan sipërfaqe të zhveshura në fshatin Malishevë të Komunës së Gjilanit, lokalitet ky i përzgjedhur për të shënuar"Ditën e Tokës" me aksione konkrete.



FORCA JONË

* * * Viti II • Nr. 13 • qershor 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Vizitë e rëndësishme e ministrit Çeku në NATO - Bruksel

Delegacioni i Republikës së Kosovës i udhëhequr nga ministri i FSK-së Agim Çeku, i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjatë qëndrimit në Bruksel, kanë zhvilluar takime zyrtare në Selinë e NATO-s dhe të BE-së.

Fillimisht në Selinë e NATO-s, delegacioni i FSK-së, është pritur nga zv. sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, ambasadori Aleksandër Vershbow, të cilin ministri Çeku e falënderoi për mbështetjen e NATO-s, në sigurinë e Kosovës dhe në zhvillimin e FSK-së.

Ministri Agim Çeku, me këtë rast e njoftoi ambasadorin Vershbow, për të arriturat dhe zhvillimin e FSK-së dhe njëherësh kërkoi nga Ai, shpalljen e Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO), në një afat sa më të shkurtër dhe të avancojë në marrëdhëniet me NATO-n, duke i hapur dyert e NATO-s për Kosovën, përfshirë këtu pjesëmarrjen në operacione nën udhëheqjen e NATO-s, pjesëmarrjen e pjesëtarëve të FSK-së, në shkollat e NATO-s, etj.

Ambasadori Vershbow, çmoi lartë zhvillimet dhe të arriturat e FSK-së dhe konfirmoi se shpallja e Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO) do të ndodhë së shpejti dhe me shpalljen e KPO-ve, marrëdhëniet me NATO-n, do të avancohen.

Ai, gjithashtu konfirmoi se NATO-ja do të vazhdojë ta mbështesë zhvillimin e FSK-së dhe është e vendosur për vazhdimin e mbajtjes së sigurisë në Kosovë.

Ndërsa, në BE, ministri Agim Çeku u prit nga Maciej Popowski, zëvendës i Baroneshës Ashton dhe nga zonja Katherine Venedtt, udhëheqëse e Zyrës për Zgjerim, në Komisionin Evropian, Ministri, Agim Çeku, i njoftoi zyrtarët e lartë të BE-së, për rolin, misionin dhe detyrat e FSK-së dhe përkushtimin e saj në zhvillimin e shoqërisë. Ai, gjithashtu, kërkoi nga BE-ja që të vazhdojë angazhimi dhe përkushtim i përbashkët me institucionet e BE-së në Kosovë.



Sipasë Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë

Forca e Sigurisë së Kosovës është më e besueshmja për qytetarët e Kosovës

Në një anketë të organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, të mbajtur gjatë muajit prill-maj, ka nxjerrë Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) më të besueshmen për qytetarët e Kosovës.

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, ditë më parë, ka publikuar rezultatet paraprake të sondazhit "Barometri Kosovar i Sigurisë", në vlerësimin e sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe politikës së jashtme. Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës ka dalë të jetë më e besueshmja. Qytetarët e Kosovës, sipas këtij publikimi, më së shumti i besojnë FSK-së dhe janë shprehur të kënaqur me punën e saj, më 72 % .

Drejtori i kësaj qendre, Florin Qehaja, ka thënë se programi "Barometri Kosovar i Sigurisë" ka për qëllim të bëjë matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me institucionet e sigurisë. Përmes këtij hulumtimi, ne, po ju kontribuojmë proceseve të rëndësishme në vend, ngase konsiderojmë që tashmë ka ardhur koha që fjala e qytetarëve të mbizotërojë në raport me vendimet që merren në nivel qeveritar dhe në nivel të lartë ndërkombëtar.

Sipas kësaj qendre; të anketuarit u pyetën se a ishin të kënaqur me punën e institucioneve të sigurisë, duke dhënë mendimin e tyre, në një gradë të bazuar në shkallën e "Likert" :1- shumë të pakënaqur, 2-të pakënaqur, 3-disi, 4-të kënaqur, 5-shumë të kënaqur etj.

Të anketuarit rezultuan të ishin të kënaqur me punën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) 72% të pasur nga zjarrfikësit me 69 % , nga KFOR-i me 59% dhe nga Policia e Kosovës me 42% e kështu me radhë.

Ndërsa, në pyetjen për korrupsionin, sipas kësaj qendre, FSK-ja prin për të mirë, ku 74% e të anketuarve, thonë se, kryesisht, FSK-ja nuk është e korruptuar.



Konferenca "Sfidat e Sigurisë Detare në Adriatik dhe Jon"

Konferenca me temë "Sfidat e Sigurisë Detare në Adriatik dhe Jon", u organizua nga Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes (QKSM) e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së në Tiranë. Në hapjen e punimeve të konferencës të pranishmit i përshëndeti me një fjalë rasti kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha.

Në seancën kryesore të konferencës foli ministri i FSK-së, Agim Çeku i cili ndër të tjera në fjalimin e tij tha: "Është e pamundur të flitet për interesa të izoluara të secilit prej nesh. Kërcënimet me të cilat ne përballemi janë rajonale dhe globale. Pra perceptimi ynë dhe përgjigjja jonë duhet të jenë po ashtu regjionale dhe globale".

Në këtë konferencë morën pjesë: ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku, ambasadori i SHBA në Tiranë, Alexandër Arvizu, Franco Fratini nga Bashkimi Europian, ministri i Mbrojtjes i Maqedonisë, Talat Xhaferi, zëvendësministri i Mbrojtjes i Greqisë, Panagiotis Karampelas, përfaqësues të lartë nga Ministria e Mbrojtjes e Kroacisë, Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, si dhe përfaqësues nga organizma të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kësaj fushe.

Konferencën e përshëndeti edhe ambasadori i SHBA në Tiranë, z. Alexandër Arvizu. Gjithashtu në kanë paraqitur fjalën e tyre edhe ministri i Mbrojtjes i Maqedonisë, Talat Xhaferi si dhe përfaqësues të lartë nga Ministria e Mbrojtjes e Kroacisë, Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, etj.

Konferenca "Sfidat e Sigurisë Detare në Adriatik dhe Jon" u zhvillua në kuadër të iniciativës së Adriatikut dhe Jonit, iniciativë e krijuar në vitin 2000, në Ankona të Italisë.

Qëllimi i konferencës për Sigurinë Detare ishte shkëmbimi i eksperiencës dhe praktikave më të mira të vendeve të rajonit tonë në fushën e sigurisë detare; krijimi i një mirëkuptimi më të gjerë dhe një bashkëpunimi më të mirë ndaj rreziqeve dhe sfidave për sigurinë detare.

Fjala e ministrit në Konferencën"Sfidat e Sigurisë Detare në Adriatik dhe Jon"

Të nderuar ministra, të nderuar kolegë, zonja dhe zotërinj

Do të filloj me pyetjen, pse ministri nga vendi pa bregdet është i interesuar të marrë pjesë në një konferencë për sigurinë detare? Dhe do të përgjigjem në pyetjen time: Sepse asnjëri nga ne më nuk ka interesa individuale të sigurisë.

(Vazhdon në faqen 3)

Gjeneral Kastrati dhe ambasadorja Jacobson vizitojnë deminierët në Dobërqan

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant, Kadri Kastrati, së bashku me ambasadoren e SHBA-ve, në Kosovë, Tracy Jocobson, qëndruan për një vizitë pune në fshatin Dobërçan të Komunës së Gjilanit. Gjeneral Kastrati dhe ambasadorja Jacobson, përcollën nga afër punën e deminerëve të FSK-së, të cilët nga data 2 prill po vazhdojnë të bëjnë deminimin e këtij territori nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera, të mbetura që nga lufta e fundit në Kosovë.



Për punën që po bëjnë çminuesit e FSK-së, në Dobërçan, gjeneral Kastratin dhe ambasadoren Jacobson, i njoftoi kapter Kalisi, i cili ndër të tjera tha: "Jemi duke u angazhuar maksimalisht për pastrimin e terrenit nga minat dhe mjetet e tjera të rrezikshme për jetën. Deri më tani kemi pastruar mbi 1700 m^2".

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ndihmuar dhe po ndihmojnë vazhdimisht FSK-në, përkatësisht Kompaninë e Deminimit të FSK-së, me automjete dhe pajisje të tjera profesionale për punë, me qëllim që deminerët ta kryejnë punën e tyre me sukses në terren.

Me këtë rast, ambasadorja e SHBA-ve, Tracy Jacobson, në fjalën saj i përgëzoi deminerët e FSK-së për punën e tyre të shkëlqyer për pastrimin e zonave të rrezikshme nga mjetet e pashpërthyera. Për të shtuar më tej se SHBA-të dhe Ambasada amerikane krenohet me punën tuaj të guximshme dhe njëkohësisht të rrezikshme".

Në fund, gjeneral Kastrati, përshëndeti pjesëtarët e deminimit për profesionalizimin e treguar gjatë punës së tyre. Ai shtoi se: "Kompania e Deminimit e FSK-së, për tri vite, ka pastruar mbi 70.000 m^2, duke shkatërruar mijëra mjete të pashpërthyera, ku si pasojë e të cilave kanë humbur jetën 115 veta dhe 454 të tjerë kanë pësuar lëndime të rënda trupore.

Aktualisht, në Kosovë janë identifikuara 54 fusha të minuara dhe dyshohet edhe për 44 fusha të tjera "Pjesëtarët e FSK-së do t'i vizitojnë këto fusha dhe do t'i verifikojnë nëse ato janë të rrezikshme për jetën e këtyre banorëve. Ai kujtoi edhe rastin kur një punëtor i IPKO-s, në këtë fshat, gjeti vdekjen nga një minë".

Zëvendësministri Veseli priti drejtorin e Divizionit për Siguri të Gjermanisë

Zëvendësministri i FSK-së Shemsi Veseli i shoqëruar edhe nga këshilltarja politike për siguri, znj Besa Kabashi, priti dr. Jasper Wieck - drejtor i Divizionit të Sigurisë në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, të shoqëruar nga i ngarkuari me punë i Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë z. Mathias Kiesler dhe z. Sebastian Gerhard nga Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Gjatë takimit u bisedua për zhvillimet aktuale në FSK, bashkëpunimet dypalëshe dhe shumëpalëshe në rajon dhe më gjerë, si dhe për procesin e rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë në Kosovë.



Zëvendësministri i FSK-së, Gashi pritet nga zv. ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, Musaraj

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) Bejtush Gashi së bashku me zv. komandantin e Komandës së Forcave Tokësore (KFT) të FSK-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, qëndruan për një vizitë zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, ku u pritën nga zv. ministrja e Mbrojtjes, prof. dr. Arta Musaraj.

Qëllimi i vizitës ishte vazhdimi i bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, midis dy ministrive dhe dy forcave, FSK-së dhe Ushtrisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe intensifikimi i marrëdhënieve në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Zv.ministri Gashi e ka njoftuar homologen e tij me të arriturat e përgjithshme të FSK-së dhe me të ardhmen e saj.

Ndërsa, zëvendësministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, Arta Musaraj, ka falënderuar zv.ministrin Gashi dhe njëherësh është shprehur: "Midis Shqipërisë dhe Kosovës ka një bazë nisje shumë të fortë, pasi që bashkëpunimi i deritanishëm në fushën e mbrojtjes, mbështetja në proceset integruese në NATO, si dhe të strukturimi i FSK-së dhe sistemit të mbrojtjes së Kosovës, në përgjithësi është një bazë shumë e mirë fillimi, është bashkëpunim i strukturuar. Sot, ne, falë ndërveprimeve, kemi struktura të përbashkëta që kanë synime e detyra të mirëfillta në arritjen e objektivave të caktuara në kuadër të këtij bashkëpunimi".

Ambasadorja e SHBA-ve, Jacobson vizitoi Komandën e Forcës Tokësore

Komandanti i Forcës Tokësore (KFT) të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjeneralmajor Rrahman Rama priti sot, ambasadoren e SHBA-ve në Republikën e Kosovës, Tracy Jacobson dhe atasheun ushtarak amerikan pranë kësaj ambasade, kolonelin James Kottin. Vizita e ambasadores u realizua në Komandën e Forcës Tokësore, ku ishin të pranishëm gjeneral Rrahman Rama-shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri dhe major Berat Shala.

Gjeneral Rama e njoftoi ambasadoren Jacobson mbi zhvillimin e Forcës Tokësore, si dhe me aktivitetet dhe synimet e kësaj force në të ardhmen. Ndërsa, Tracy Jacobson u shpreh se puna dhe aktivitetet e FSK-së janë shumë të dobishme për tërë Kosovën.

Delegacioni i Ambasadës amerikane vizitoi Kabinetin e Gjuhëve të Huaja, i cili është donacion i kësaj ambasade, ku u njoftua për së afërmi me trajnimet që janë duke u zhvilluar në këtë kabinet. Më pas delegacioni vazhdoi vizitën në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, ku u njoftua nga afër me zhvillimin e sistemit të edukimit të oficerëve në FSK.



Zëvendësministri i Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë në MFSK

Zëvendësministri i Mbrojtjes i Republikë së Maqedonisë, z. Emil Dimitrev, i shoqëruar edhe nga zëvendësshefi i Shtabit të Ushtrisë, gjeneralmajor Naser Hajdini, dekani i Akademisë së Mbrojtjes, kolonel Rose Smileski dhe atasheu ushtarak i Republikës së Maqedonisë në Kosovë, kolonel Donco Kuzmanov, qëndruan për vizitë zyrtare në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Delegacionin e lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ushtrisë së Maqedonisë i priti ministri i FSK-së Agim Çeku, i cili falënderoi Maqedoninë për ndihmën e dhënë në fushën e trajnimeve dhe shkollimit të kuadrove të reja. Ai njëherësh foli edhe për bashkëpunimin e gjithanshëm e me interes të përbashkët për dy shtetet dhe rajonin. Delegacionin e Maqedonisë e priten në takime të ndara edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministrat e FSK-së, Bejtush Gashi dhe Sllavisha Filipoviqi, dhe gjeneral brigade Imri Ilazi- drejtor i Departamenti për Operacione dhe Trajnime. Në këto takime pjesëmarrësit e delegacioneve shkëmbyen përvojat dhe praktikat e tyre në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe në fushën e studimeve universitare për kadetë.

Gjatë takimit u vlerësua lartë bashkëpunimi ndërmjet dy ministrive, të cilat u zotuan edhe për bashkëpunim të mëtejmë në fushat me interes të përbashkët, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, të nënshkruar nga Ministria e FSK-së dhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë.

Delegacioni i Mbrojtjes së Maqedonisë, vizitoi Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, ku u njoftua nga afër me punën dhe aktivitetet e kësaj qendre shkollimi, si edhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandant i KDS-së, i njoftoi mysafirët me punën e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Më pastaj, delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë, vizitoi disa nga shkollat e kësaj komande duke u njohur nga afër me punën e përgjithshme në fushën e trajnimit dhe shkollimit.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org



Fjalimi i Ministrit Çeku në Konferencën "Sfidat e Sigurisë Detare në Adriatik dhe Jon"

Të nderuar ministra, të nderuar kolegë, zonja dhe zotërinj

Do të filloj me pyetjen, pse ministri nga vendi pa bregdet është i interesuar të marrë pjesë në një konferencë për sigurinë detare? Dhe do të përgjigjem në pyetjen time: Sepse asnjëri nga ne më nuk ka interesa individuale të sigurisë.

Është e pamundur të flitet për interesat e izoluar të secilit prej nesh. Kërcënimet me të cilat ne përballemi janë rajonale dhe globale. Pra perceptimi ynë, dhe përgjigjja jone duhet të jenë po ashtu regjionale dhe globale.

Ne përballemi me kërcënime terroriste dhe krimin e organizuar. Ato për nga natyra e tyre nuk njohin kufij. Në sektorin detar, regjioni Mesdhetar duhet të përqendrohet në çështjen e tentimit të imigrimit ilegal nga Afrika në Evropë; ne nuk e kemi parë këtë fenomen aq shumë në regjionin tonë, por ashtu siç rajoni ynë po stabilizohet dhe i ofrohet Bashkimit Evropian (hyrja e Kroacisë në BE fakti që na gëzon) është një dallim i rëndësishëm, ne mund të bëhemi rrugë transite.

Kufijtë detarë janë linjat në det. Madje edhe ish-ushtarët e dinë që është iluzion se mund t'i mbrojmë ato linja me rrethoja dhe të shtiremi që problemet e fqinjëve nuk janë tonat. Së shpejti do të ketë 4 pjesëtarë të BE-së në bregun Adriatik dhe Jon: Greqia, Italia, Sllovenia dhe Kroacia. Interesat e tyre të sigurisë do të jenë të lidhur ngushtë me interesat e 3 anëtarëve që nuk janë anëtarë të BE-së: Shqipëria, Mali i Zi dhe Bosnja. Të gjithë duhet të bashkëpunojnë, shtetet e BE-së dhe ato që nuk janë në BE. Duhet të bashkëpunojnë edhe ato shtete që janë larg nga bregdeti: Kosova, Maqedonia dhe Serbia. Ne e dimë që interesat tona janë ngushtë të lidhur me njëri- tjetrin dhe me shtetet në bregdet.

Vetë tema e konferencës tonë shpije natyrshëm tek tema që unë vazhdoj ta theksoj në çdo rast: nevoja për një qëndrim më koherent dhe përvoja në siguri regjionale. Siç po largohemi nga koha e jo-stabilitetit në mes të shteteve të Evropës Juglindore, mund të mendojmë jo vetëm për përfitime nga stabiliteti individual dhe ai regjional, por edhe për përfitime të stabilitetit kolektiv dhe aftësi kolektive.

Ky qëndrim është efektshmëria. Ne jemi më të efektshëm nëse punojmë së bashku, përpjekjet tona nuk shtohen, por shumëzohen dhe menjëherë bëhemi partner më tërheqës dhe më të përgjegjshëm për NATO-në dhe BE-në. Së bashku ne mund të bëjmë më shumë me më pak angazhim, duke iu shmangur dyfishimit dhe garës në mes nesh.

Kjo çështje është thelbësore. Të përballur me kërcënime regjionale dhe ndërkombëtare ne nuk mund të veprojmë individualisht. Nëse veprojmë ashtu, secili prej nesh, në shtetet tona të vogla me shumë kufi, ne vetëm do t'ju ndihmojmë terroristëve dhe kriminelëve. Dallimet tona janë zbrazëtirat përmes të cilave do të "kalojnë" armiqtë tanë. Por nëse ne veprojmë së bashku, ne po bëhemi një pengesë e fuqishme kundër krimit dhe partner i fuqishëm i partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Në Ushtrinë Romake, ushtarët individual në njësi, do t'i kishin bashkuar mburojat e tyre, disa në ballë, disa anash dhe disa lartë. Ushtari individual, i vetëm, ishte i lëndueshëm. Njësia që punon së bashku, duke i kombinuar aftësitë individuale ishte e pathyeshme dhe e pandalshme.

Të nderuar kolegë, shpresoj që sot mund të fillojmë të mendojmë për mënyrat e reja të kombinimit të aftësive tona. Çfarë mundësish mund të imagjinojmë? Politikat e përbashkëta. Doktrinat e përbashkëta. Planifikimin e bashkuar. Ushtrimet trajnuese të përbashkëta. Prokurimin e koordinuar. Operacione të koordinuara në kufijtë tanë detarë dhe tokësor. Me kalimin e kohës, ne mund të imagjinojmë zbarkimin e përbashkët në misione paqeruajtëse.

Ky është objektivi im, sepse është moment kur ne mund t'i dëshmojmë tërë botës, se kemi ndaluar së qeni konsumator i resurseve të sigurisë dhe jemi bërë ofrues të sigurisë. Suksesi fillon sot, në këtë sallë.

Gjeneralbrigade Salvatore Carta vizitoi Kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog

Shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s, për FSK, gjeneral brigade Salvatore Carta, së bashku me shefin e mentoruesve të KFOR-it, në BRSH, qëndruan për një vizitë pune në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Istog.

Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër me aktivitetet, trajnimet, gjendjen dhe arritjet e përgjithshme të BRSH-së.

Gjeneralin Carta në takim e priti komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, i cili e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të BRSH-së. Gjeneral Carta ishte i pranishëm edhe në disa nga trajnimet që u realizuan gjatë ditës sipas planit të BRSH-së.

Bashkëpunim i mirë ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë



Një delegacion i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), në kuadër të marrëveshjes dypalëshe të nënshkruar në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Gjermanisë, për vitin 2013, zyrtarisht, ka qëndruar për një vizitë në Gjermani, që nga data: 13-18 maj 2013.

Delegacioni i Ministrisë së FSK-së, gjatë qëndrimit në Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë, ka realizuar edhe një vizitë pune në Drejtorinë e Planifikimit të Ministrisë së Mbrojtjes në Bon, ku u pritë nga drejtoresha e këtij departamenti, Min Dirigin dhe kolonel Funke.

Sipas programit dhe marrëveshjes dypalëshe për bashkëpunim, delegacioni i Ministrisë së FSK-së, i përbërë nga drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Haxhi Shala, drejtori i Departamentit të Personelit, kolonel Skënder Zhitia dhe shefi i Seksionit për Plane, Programe dhe Analizë, nënkolonel Haki Hoti, u informuan gjerësisht për reformat e përgjithshme që po bëhen në Bundesverin dhe me procesin e planifikimit në Ministrinë e Mbrojtjes të Gjermanisë. Takimi u karakterizua më shumë se miqësor dhe interesimi i delegacionit të MFSK-së ishte që të përfitojë sa më shumë rreth organizimit, si në aspektin profesional dhe në atë praktik nga Drejtoria e Planifikimit të Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë.

Ndërsa, delegacioni i Ministrisë së FSK-së prezantoi të arriturat e FSK-së, si dhe procesin e planifikimeve në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjegjësisht të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Drejtoria për Politika dhe Plane e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Gjermanisë i ka ofruar bashkëpunim FSK-së në fusha të ndryshme.

Komandanti i FSK-së dhe sekretari i shtetit të Suedisë vizituan deminerët në Gërmi



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zhvilloi një takim pune në "Vila Gërmia" në Gërmi, me sekretarin e shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes të Suedisë, Carl Von der Esch, me bashkëpunëtorë.

Komandanti i FSK-së, fillimisht e falënderoi Qeverinë e Suedisë për ndihmën e pakursyer që ajo po jep për FSK-në, si dhe për angazhimin e Regjimentit të Xhenios "Göta" të Forcave të Armatosura të Suedisë, në mbështetje të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, të cilët kanë vënë në dispozicion ekskavatorët e blinduar që mund të dirigjohen nga largësia për të gërmuar ndërtesat.

Ndërsa sekretari Carl Von der Esch, pasi që e përgëzoi komandantin për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, në fjalën e tij foli edhe për bashkëpunimin në mes të dy ministrive, duke premtuar vazhdimin e ndihmës për FSK-në edhe në të ardhmen.

Më pas ata vizituan, në vendin e ngjarjes, ekipin e Regjimentit të Xhenios "Göta" të Suedisë dhe atë të FSK-së, të cilët po pastrojnë parkun "Gërmia" nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera.

Sipas njoftimit nga ekspertët e FSK-së dhe të Suedisë, që nga fillimi i punës janë pastruar mbi 2000 m^2, ku janë gjetur 15 kastë bomba, 3 granata dore dhe pjesë të tjera eksplozive, si dhe janë hequr mbi 110 kamionë me mbeturina.

Me këtë rast, gjenerallejtënant Kadri Kastrati u shpreh shumë i kënaqur me angazhimin e përbashkët të FSK-së dhe të ekipit të Regjimentit të Xhenios "Göta"të Suedisë. Po ashtu edhe sekretari Carl Von der Esch, u shpreh i kënaqur që Forcat e Armatosura të Suedisë, përmes kontingjentit të saj, janë angazhuar në operacione të çminimit së bashku me FSK-në. Ai njëherësh ndjehet i lumtur që shteti suedez, përmes këtij aktiviteti, po mundëson një jetë më të lehtë për qytetarët e Kosovës.

Operacioni i deminimit në parkun" Gërmia" në Prishtinë po vazhdon me sukses dhe pritet që të përfundojë në fund të muajit qershor 2013.

FSK-ja pastron Luzhnicën nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera

Mbi 45.000 m² kanë pastruar çminuesit e FSK-së, në malet e fshatit Luzhnicë të Kleçkës, Komuna e Therandës, si dhe kanë shkatërruar mbi 43 bomba kasetë dhe mjete të tjera të pashpërthyera të mbetura që nga pas lufta në Kosovë.





Ditë më parë, ekipi ynë, vizitoi Njësitin e Deminimit në malet e Luzhnicës, ku u takuam me deminerët të cilët me përgjegjësi të lartë po bëjnë pastrimin e këtyre maleve nga mjetet e pashpërthyera dhe të rrezikshme për jetën e këtyre banorëve. Në këto male, në vend të cicërimave të zogjve, hasëm zhurmën e lokatorëve, të cilët deminerët tanë e kanë armën e parë dhe të vetme për gjetjen e minave dhe mjeteve të tjera të pashpërthyera. Këtu po punojnë pjesëtarët e dy togjeve të Kompanisë së Deminimit, ata të Togut të Parë dhe të Tretë.

Përgjegjësi i Togut të Parë, rreshter Gani Tarakaj na tha: Këtë vit, punën e kemi filluar që nga 3 prilli i vitit 2013. Që nga fillimi i punës, vitin e kaluar dhe deri më tani kemi pastruar më shumë se 45.000 m² hapësirë dhe njëherësh kemi gjetur dhe shkatërruar më shumës e 43 mjete të pashpërthyera, kryesisht, bomba kasetë dhe mjete të tjera eksplozive Vendi ku jemi duke punuar, është një hapësirë e madhe dhe rreziku më i madh, për ne, nuk janë vetëm bombat kasetë dhe minat, por edhe gjarpërinjtë, rriqrat dhe insektet tjera, shton rreshter Tarakaj.

Ndërsa përgjegjësi i Togut të Tretë, rreshter Gega u shpreh: "Të gjithë pjesëtarët e deminimit; kanë kryer trajnime profesionale për këtë fushë, ndërsa, disa nga ta kanë përvojë edhe më të gjatë, sepse ata kanë shërbyer në TMK, dhe kjo përvojë ka bërë që deminerët e FSK-së, t'i kryejnë detyrat me përgjegjësi dhe me profesionalizëm të madh".

Fjalë e këtyre rreshterëve i dëshmojnë edhe rezultatet e shkëlqyeshme gjatë punës së tyre, ku kanë hulumtuar mijëra e mijëra metra katror dhe kanë shkatërruar me mijëra mjete të pashpërthyera me sukses dhe pa asnjë incident. Edhe përkundër disa mungesave teknike si bateri të lokatorëve dhe çizme, ata po e kryejnë punën-pastrimin e terrenit me përgjegjësi të madhe.



Në mesin e deminierëve takuam edhe infermieren Nita Vula, e cila çdo ditë punon së bashku me deminerët e Togut të Parë. Infermiere Vula ka një përvojë më shumë se trevjeçare si deminere në FSK. Gjatë bisedës me ne ajo u shpreh: "Unë e ndiej vetën njeriu më i lumtur që kam arrit, sado pak, të punojë për qytetarët e mi dhe t'ua mundësojë atyre lëvizjen e lirë dhe pa probleme, kudo në Kosovë. Kjo është një detyrë që kërkon shumë kujdes, shumë përqendrim, shumë përgjegjësi, shumë profesionalizëm, përndryshe mungesa e tyre sjell pasoja shumë të mëdha.

Ndërsa, Mejdi Abazoviqi, me përkatësi boshnjake, është po ashtu nga deminerët që kanë filluar punën në TMK dhe vazhdon ta kryej me sukses edhe sot në FSK . Ai ndjehet i lumtur dhe i nderuar që punon me ekipin e deminerëve të FSK-së. Në mesin e këtij ekipi, Mejdiu, ndjehet si në mesin e familjarëve të tij, i barabartë si në aspektin kombëtar ashtu edhe në atë fetar.

E vetmja ushtare që e kryen detyrën e deminimit, është Mimoza Terziu, e cila i takon gjeneratës së parë që është pranuar në FSK-së. Mimoza është e përgatitur profesionalisht dhe e kryen detyrën me përgjegjësi të lartë na tha komandanti i saj, rreshter Gega. Ndërsa, Mimoza për punën e saj shprehet:"Prej fillimit punoj në Kompaninë e Deminimit të FSK-së. Kam qenë pjesë e ekipit të çminimit në këto fusha: Milaj, Stakë, Belincë, Kërsteç, Dragash, Luzhnicë, etj. Kurrë nuk kam pasur asnjë problem gjatë punës në FSK. Falë bashkëpunimit të mirë në mes të deminerëve dhe përgatitjes profesionale po i kryejmë detyrat me përgjegjësi. Ndjehem shumë krenare me punën time të cilën e kryej me pasion dhe dashuri " përfundon mendimin e saj Mimoza Tërziu.

Deminierët e FSK-së, të veshur me jelekë antiplumb, midis kësaj parajse të natyrës, po kryejnë një punë të rëndë dhe me plotë rreziqe. Para tyre dorëzohen edhe minat, kasetë bombat dhe materiali tjetër eksplozive.

Në malet e Luzhnicës, është një rekordmen i gjetjeve të kasetë bombave, demineri Denis Tabaku, i cili deri më tani në këto male ka zbuluar 12 kasetë bomba. "Kjo për mua është një punë sa humane dhe e mirë, aq edhe me përgjegjësi, sepse çdo ushtar, ballafaqohen me rreziqe të paparashikueshme. Së bashku me kolegët e mi ne po punojmë me përgjegjësi dhe profesionalizëm të lartë dhe falë kësaj po arrijmë rezultate të larta, ku zbuluam 12 kasetë bomba.

Të njëjtin mendim me Denisin e ndajnë edhe rreshterët Valon Avdyli, Arsim Kodra, Driton Buçaj etj.

Ekipet e Kompanisë së Deminimit të FSK-së, në nivel vendi, po i pastrojnë edhe këto fusha të minuara: Gërmi, Milaj, Ferizaj, Belincë, Harilaq, Vermicë dhe Koshare.

Ne u ndamë nga deminerët, duke u uruar një ditë të mirë dhe të suksesshme.





Regjimenti i Mbrojtjes Civile testoi aftësitë reaguese në ushtrimin fushorë “Pranvera 2013”



Regjimenti i Mbrojtjes Civile (RMC) i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) të FSK-së, përfundoi me sukses ushtrimin fushor "Pranvera 2013", në të cilën kanë qenë të angazhuar të gjitha njësitë e saj operacionale, si: Task Forca, Kompania e Deminimit, Kompania e Mbrojtjes Kimiko-Atomiko-Biologjike (MKAB), si dhe Kompania Mbështetëse.

Qëllimi i këtij ushtrimi ishte testimi i gatishmërisë, aftësisë reaguese të pjesëtarëve të këtyre njësive, realizmi i planit vjetor, përgatitja e pjesëtarëve për raste reale të cilat mund të ndodhin në ndërkohë, parapërgatitja për ushtrimin fushorë të Brigadës për Mbështetje Operacionale si dhe ushtrimit fushor në kuadër të FSK-së.

Komandanti i RMC-së njëherit komandant i ushtrimit "Pranvera 2013" kolonel Shaip Haziri, tha se ushtrimi është zhvilluar sipas planifikimit dhe direktivave, dhe u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur me dinamikën e zhvillimit të stërvitjeve. Kolonel Haziri e konsideroi privilegj drejtimin dhe komandimin e RMC-së, pikërisht për shkak që pjesëtarët e kësaj njësie operacionale janë të motivuar dhe të gatshëm për të reaguar me sukses edhe në situate reale.

Në ushtrimin "Pranvera 2013", Regjimenti i Mbrojtjes Civile ka pasur të angazhuar njësitë e saj operacionale për të testuar gatishmërinë, aftësitë reaguese të pjesëtarëve të këtyre njësive. Pjesë e këtyre ushtrimeve simultante ka qenë edhe njësia e sapoformuar e Task Forcës e cila misionin e saj e ka të trashëguar nga e kaluara e ish-TMK-së, të cilët, për 9 vjet kanë kryer operacione reale në kërkim- shpëtim. Kjo njësi 90% është njësi operacionale në fushat e kërkim-shpëtimit në male, në ujëra, në raste urbane dhe në zjarrfikje. Task Forca në strukturën e saj, ka 127 pjesëtarë të cilët janë seleksionuar në bazë të disa kritereve të cilat kanë qenë të obliguara që të kalohen. Ata janë të përkushtuar në punën dhe misionin e tyre dhe gjithashtu kanë motiv dhe përkushtim në punën e tyre. Kjo njësi në ushtrimin "Pranvera 2013" është përballur me situata të kërkim shpëtimit në ujëra dhe kërkim shpëtimit në male.

Situatat në të cilat Task Forca është duke kalitur aftësitë e saja, janë situata të ngjashme në të cilat ajo ka intervenuar në operacione reale gjatë këtij viti, si; në përmbytjet në Istog dhe Klinë, duke mundësuar shpëtimin e jetës së banorëve të rrezikuar.

Stërvitja dhe kalitja e pjesëtarëve të Task Forcës, do t'u shërbejë për të qenë të suksesshëm në raste të dislokimit jashtë vendit; si në ushtrimet; "Shared Resilience" në Republikën e Maqedonisë dhe ushtrimin "Joint Reaction" në Republikën e Shqipërisë, që do të zhvillohen gjatë muajit qershor.

Në ushtrimin e RMC-së, në Batllavë, Kompania e deminimit ka qenë e angazhuar në testimin e aftësive për deminim dhe eliminim të mjeteve të pashpërthyera në një zonë me materie kimike helmuese e që pjesëtarët e kompanisë së MKAB-së, janë angazhuar që së pari të bëjnë detektimin (zbulimin) e materieve helmuese kimike, më pas të bëhet dekontaminimi i vendit, në mënyrë që t'u krijoj mundësinë për intervenim e njësive tjera. Në fund, kanë bërë edhe dekontaminimin e pajisjeve dhe personelit.


Ushtrimi i RMC-së "Pranvera 2013" është mbajtur në afërsi të Liqenit të Batllavës, për katër ditë, e ku janë angazhuar 209 pjesëtarë. Ky ushtrim ka pasur për qëllim ngritjen e gatishmërisë dhe motivin e pjesëtarëve për t'i shërbyer vendit në situata reale.





FORCA JONË

Me krijuesit artistik të FSK-së



Bajram Bekteshi ka lindur në fshatin Samadraxhë, Komuna e Therandës Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, të mesmen në Therandë, ndërsa Fakultetin Filozofik- dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Universitetin e Prishtinës. Me shkrime është marrë shumë herët, qysh sa ishte nxënës në bankat e shkollës fillore. Bajram Bekteshi ka botuar shumë përmbledhje me poezi dhe tregime si: "Këmisha e përgjakur " 1995, "Erërat s'mbahen në grusht" 1996, "Pije gjakun tim" 1997, "Kërkimtari" tregime, 1998, "Hapa për mbijetim" poezi 2000, "Mbizotërat" 2003, "Shtigjeve të dritës" poezi 2005, "Unë dhe vargu" poezi 2005 etj.

Në rrugën jetësore të veprimtarit të lirisë, Bajram Bekteshi, asnjëherë nuk ka ndaluar meditimin poetik, që tashmë iu ka bërë fiksim jetësor, një bar shërues, që i shërben për ta mbajtur baraspeshën edhe për t'i përballuar rravgimeve e sfidave që sjellë jeta. Poeti, në krijimtarinë e tij, stigmatizon të keqën, hipokrizinë dhe djallëzinë e cila pretendon të jetë ndryshe. Poeti edhe përkundër sfidave djallëzore, që i krijohen në jetë, Ai ngadhënjen me qëndresën dhe këmbëngulje me një forcë e trimëri, për të jetuar vertikalisht. Ai në përgjithësi, vetëm kështu i jep kuptim jetës dhe në veçanti duke i lënë porosi universale brezit të ri dhe për ta bartur nga brezi në brez. Autori që nga përmbledhja e tij e parë "Këmishë e përgjakur" e deri tek përmbledhja e fundit mbizotëron lufta me të keqën, ku e drejta fiton ndaj të padrejtës, në përgjithësi. Bajram Bekteshi, në krijimtarinë e tij, përdor një gjuhë të pasur; me plotë metafora dhe simbole, që i jep ritëm dhe fuqi artistike vargut. Ai, për temat e poezisë së tij, frymëzohet nga bota e djeshme dhe bota e sotme; me porosinë e përgjithshme për të ardhmen. Poeti, që nga përmbledhja e parë e deri më tani ka arrit të përfitojë një përvojë në finalizimin e mesazheve dhe ngritjes artistike të vargut.

Dje dhe sot

I veshur palaço, pa dashje shpalos rrënjët vetës
Këngëve të sirenave ua vë gishtin në varg,
Kërkon historinë e Ali Babës me dyzetë cubat
Apo të Odisesë në shtegun e kthimit për Itakë.

Si t'jesh Zeusi i fuqishëm mbi Malin Tomor
Ndjeve borgjezësh e matrapazësh rëndë në paraqitje,
Kokë e këmbë i njëjti je dje dhe sot
Hynë në vallen e shtrigave, hedhë hapin e tyre.
Karnavaleve të moteve, Kameleon në udhëtim
Rrugëve ua njehë zik-zaket, maskave ua lypë rrudhat,
Gjen vendpushimin tek Kroi i Thatë
Të dukesh i veçantë në botën e hiçit.

Intervistë mbrëmjeje

Ç'të të them në këtë mbrëmjeje
Nën shiun e ftohtë,
Nga lumi i tërbuar
Trishtohet lugu i thellë.
S'ka net të qeta,
As gjumë ninullash,
Tani të gjithat
Kanë thyer rregullat.
Fjalën e nxjerrë
E kush s'më dëgjon
Njerëzit e tokës sime
Ecin si të dehur,
Sikur laboratorëve
T'ua kanë vjedhur trurin
E kanë harruar adresën
Më së keqi...emrin.
Ç'të të them këtë natë
Nën shiun rrebesh
Azdisur natyrës,
Trajtohem i huaj
Të tokën time erë gjaku.
Në horizontin e kuqërremtë
Kandilat rijnë ndezur,
Plagët e padegëzuara
Kërkojnë barëra populli

Grisa qefinin e vdekjes

Natën pa hënë, grisa qefinin e vdekjes
Hijet ogurzeza u trazuan në çerdhet e tyre,
Lidhë fijet e këputura të shamisë së kuqe,
Për ta rikthyer imazhin e tërësisë së saj.
Në fytyrën e rrudhatendosur të rrahur nga era
I radhita vitet si libra në bibliotekë,
Kapitujt vargëzuar si hallkat lëshuar horizontit
Ta nxjerrin hapësirës burimin e dritës në flakërim.
Rrugën e kortezhit e ktheva në rrugën e dasmave
Për të lindur e rritur çdo gjë për së mbari,
Vallet e qyqeve u kthyen në listën mortore
Shqiponja ka filluar rikthimin e çerdhes.

Bajram Bekteshi, edhe përkundër punës së vazhdueshme që bënë në FSK-së, ai gjen frymëzim për krijime të reja, të përditshme. Ne po i sjellim disa nga poezitë e tij, të botuara në përmbledhjen e fundit "Intervistë mbrëmjeje"

Naim Ymeri me shkrime filloi të merret që nga bankat e shkollës fillore, për ta vazhduar më pas si nxënës i shkollë së mesme, si student në fakultet dhe po ashtu gjatë shërbimit në TMK dhe FSK. Naim Ymeri është përgjegjës i Bibliotekës së KDS-së, të FSK-së, në Ferizaj. Kryesisht merret me krijimin e poezive, duke mos e lënë anash edhe tregimet dhe humorin. Naim Ymeri ka botuar poezi dhe tregime në gazetat e kohës, si: "Zëri i rinisë", "Bota e re", "Rilindja", "Rilindja për fëmijë", "GEP"," Thumbi", "Bujku", etj. Së fundmi, Naimi ka botuar librin me poezi: "Nëpër Fortuna" 2011, tani ka gati për botim edhe një libër tjetër, me poezi. Autori në librin, "Nëpër Fortuna" sjellë tema të ndryshme dhe motive, kryesisht, nga historia e popullit tonë. Temat më të preferuara të autorit, janë: atdheu dhe liria, ndërsa motivet janë të shumta, ku mbizotëron motivi patriotik, motivi social dhe ai erotik! E veçanta në poezinë e tij, janë heronjtë, dëshmorët, martirët dhe atdhetarët që dhanë jetën e tyre për të vazhduar jeta e Shqiptarisë. Ai, në krijimtari, është më shumë se origjinal, ka krijuar stilin e vet, e ku, mbizotëron filozofia e atdhedashurisë, filozofia e flijimit të jetës për jetën e re, p.sh. Si "Pelikani" që hap gjoksin, për ushqimin e të vegjëlve të vet, me qëllim të vazhdimit të jetës së re, edhe autori, përdorë në të shumtën filozofinë e flijimit për vazhdimin e jetës së re. Poeti, në poezi përdorë një gjuhë të rrjedhshme, gjuhë me një karakteristikë të veçantë, për t'i dhënë fuqi rimës, fuqisë artistike dhe vlerë poezisë. Autori në përmbledhjen me poezi, me titullin shumë simbolik, "Nëpër Fortuna", shtjellon edhe tema të tjera, kryesisht me motive kombëtare. Nga kjo përmbledhje me poezi kemi zgjedhur, poezitë:



PËR LIRI

Malin me gjoks
Kam shtyrë
Në themër ujku
Ujë kam pirë
Me aromë dushku
Kam shuar urine…
Me përbuzje
Vrarë kam tradhtinë
Me urrejtje robërinë
Luftuar kam
për një trohë
Liri…

ATY

Aty filloi rilindja jonë
Aty u dha kushtrimi i Lirisë
Aty u vu gurthemeli i Pavarësisë.
Aty kënga kishte një melodi
Aty u dha kushtrimi: "O vdekje O liri"
Aty ishim të ftuar unë e ti
Aty luftohej për Kosovë, Preshevë,
Aty luftohej për Iliridë e Çamëri
Aty luftohej për Malësi
Aty luftohej për një SHQIPËRI.

Aty armët me tiktakun e tyre tregojnë
Aty bëhet historia jonë
Aty botës mesazhe i dërgojnë
Luftën për LIRI s'do e ndalojnë.
Aty kishte një qëllim
Aty u betuan në flamur për BASHKIM.
Aty u bë betimi i shqiptarisë
Aty në fushëbetejën e trimërisë.
Aty edhe nënat lan porosi
Kështu rriten djemtë për shqiptari
Aty edhe fëmijët hynë në histori
Për një ardhmëri
Shqipëria të jetë një.
Aty filloi epoka jonë e re
Aty filloi Nëntori i tretë
Aty është Nëntori i tretë
Aty frymohet me Nëntorin e tretë.

(Mars, 1998)

Kontingjenti i FSK-së po përgatitet për Maratonën Ushtarake në Holandë

35 pjesëtarë të FSK-së çdo të enjte vazhdojnë ecjet nga 20-40 kilometra në ditë, me qëllim të përgatitjeve sa më të mira fizike para se të marrin pjesë në marshim i cili do të mbahet në Holandë, gjatë muajin korrik, ku do të marrin pjesë ushtarë nga shumë shtete të botës. (Në dy vitet e kaluara, Kontingjenti FSK-së, në këtë marshim, që është tradicional, kishte zënë vendin e parë).

Komandantja e Kontingjentit të FSK-së, toger Fatbardha Osaj, thotë:"Ushtrimet po i mbajmë plotësisht sipas planit paraprak. Kemi filluar me ecje 10 kilometra dhe çdo herë duke e rritur këtë distancë, tani arrijmë distancën 40 kilometra pa problem. Tashmë të gjithë pjesëmarrësit janë të përgatitur fizikisht dhe moralisht që të marrin pjesë në marshimin që do të mbahet në Holandë.

Deri në fund na kanë mbetur edhe 200 kilometra, që çdo ushtarë t'i kalojë 4010 kilometrat e planifikuara me qëllim të përgatitjes sa më të mirë fizike dhe morale të pjesëtarëve të FSK-së. Harmonia në mes të pjesëtarëve të FSK-së, është në nivelin më të lartë. Në kuadër të këtij kontingjenti po marrin pjesë, për herë të parë, edhe katër ushtare, të cilat gjatë ushtrimeve po tregojnë një gatishmëri dhe disiplinë të madhe e që janë bërë shembull edhe për pjesëtarët e tjerët, shton në fund, Toger Osaj.





Kontribut i çmushëm i FSK-së, në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën"

Në organizimin e Departamentit Civil-Ushtarak të MFSK-së, aksionit të iniciativës qytetare në projektin "Ta pastrojmë Kosovën", i janë bashkuar edhe njësitet e FSK-së në tërë territorin e Kosovës.

Në këtë aksion FSK -ja ka ofruar kapacitetet e saja, ku janë angazhuar 275 pjesëtarë të FSK-së dhe 41 automjete, që së bashku me mijëra qytetarë të Kosovës kanë ndihmuar në përmbylljen me sukses të kësaj fushate, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e publikut për krijimin e një ambienti të pastër për të gjithë qytetarët.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka ofruar kapacitetet e saja me pjesëtarë dhe makineri, për të përmbyllur sa më me sukses këtë fushatë për pastrimin e Kosovës. Pjesëtarët e FSK-së janë përshëndetur nga mijëra qytetarë, të cilët së bashku me pjesëtarët e FSK-së kanë kontribuar në krijimin e një ambienti të pastër.

FSK-ja ndihmon “manifestimin” e personave me distrofi muskulare

Departamenti Civil-Ushtarak i MFSK-së mbështeti Organizatën e Personave me Distrofi Muskulore të Kosovës (OPDMK), me rastin e shënimit të javës së distrofisë me moton "Sfida dhe dëshira ". Në këtë aktivitet i cili u mbajt në Kalanë e Prizrenit morën pjesë qindra veta të prekur nga kjo sëmundje. Përveç FSK-së aktivitetin e ndihmuan edhe pjesëtarët e KFOR-it turk, Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, CARITAS-it etj.

Antigona Shestan, kryetare e Organizatës së Personave me Distrofi Muskulore, është shprehur tejet e kënaqur me ndihmën e pakursyer të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët ëndrrën e këtyre personave arritën ta bëjnë realitet. Ajo ndër të tjera tha: "Qëllimi ynë ishte që këtë ditë ta shënojmë më ndryshe. Ta vizitojmë Kalanë tonë të bukur këmbë. Kjo do të ishte vetëm një ëndërr e parealizueshme po mos të ishte FSK-ja, ushtarët tanë, ata të cilët na ndihmuan në realizimin e ëndrrës sonë. Forca jonë këtë ëndërr na e bëri të lehtë, na e bëri të mundshme dhe të realizueshme. Për këtë i falënderoj me mijëra herë nga zemra". Ishin këto fjalë emocionuese të përcjella nga kryetarja e kësaj organizate, të cilat njëherësh shprehën emocionet e shumë personave që vuajnë nga kjo sëmundje.

Pas kësaj vizite personat që ishin në Kala u ndjenë tejet të kënaqur dhe shprehen mirënjohjen e tyre për ushtarët e FSK-së, të cilët i ndihmuan duke i bartur qoftë në krahë qoftë me karroca dore.

Në emër të FSK-së personat me distrofi muskulore i përshëndeti nënkolonel Enver Dugolli, i cili i siguroi të pranishmit se ndihma e FSK-së për ta nuk do të mungojë asnjëherë. Më pas ai shtoi: "FSK-ja, gjithmonë, është pranë qytetarëve të saj, pranë të gjitha kategorive, pa dallim gjinie, race dhe feje, për t'ju dalë në ndihmë. Edhe sot jemi këtu me ju për të ju mbështetur në javën tuaj që tashmë është bërë tradicionale. Ju kemi mbështetur vitin e kaluar, po ju mbështesim tani dhe ju premtoi se do të ju mbështesim edhe në ardhmen" tha në fund të fjalës së tij nënkolonel Dugolli.





Pas vizitës dhe qëndrimit disa orësh në Kala, personat me distrofi muskulore të ndihmuar nga ushtarët e FSK-së u kthyen në "Sheshin e Shatërvanit", për të vazhduar aktivitetin me garën e maratonës dhe më pas programin e tyre të përgatitur më këtë rast. Shënimin e kësaj dite e bëri edhe më të veçantë shpërndarja e dhuratave për personat me distrofi muskulore nga KFOR-i turk, LMT dhe KFOR-i zviceran.

Certifikohen 41 nënoficerë të FSK-së



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kursit bazë për nënoficerë, gjenerata e parë 2013.
Kursi është realizuar nga instruktorët e KDS-së, ku për pesë javë rresht këtë kurs e kanë ndjekur 41 pjesëtarë të FSK-së.
Kursi ka qenë i mbyllur (rezident) dhe ishte një kombinim i pjesës teorike dhe praktike, gjatë trajnimeve. Temat kryesore të cilat janë ligjëruar, kanë qenë: Udhëheqja ushtarake, koncepti zhvillimor i nënoficerit, drejtimi i brendshëm, përgatitja fizike, teknikat e ligjërimit dhe rregullorja rreshtore, etj.
Kursi është vlerësuar mjaft i suksesshëm dhe frytdhënës, ndërsa, angazhimi i nënoficerëve ka qenë në nivelin më të lartë, si dhe është përcjellë me një interesim jashtëzakonisht të lartë nga nënoficerët, të cilët ishin të etshëm për të nxënë njohuri të reja, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.
Me rastin e certifikimit, kadetët i ka përshëndetur komandanti i KDS-së gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili përveç tjerash tha: "Trajnimet e tilla bëhen me qëllim të avancimit të pjesëtarëve të FSK-së, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë praktik. Unë kërkoj nga kadetët që këto njohuri të fituara t'i bartin me përgjegjësi në njësitë e tyre. Zhvillimi i nënoficerëve, gradualisht, është duke marrë formën e duhur për avancimin e tyre", tha në fund gjeneral Cikaqi.
Nënkoloneli Di Marcio, mentorues i NATO-s në KDS, tha se angazhimi i instruktorëve të KDS-së në realizimin e trajnimeve është për t'u vlerësuar lartë, ndërsa nga pjesëtarët e certifikuar, kërkoi që këto njohuri t'i shpërndajnë tek kolegët e tyre, nëpër njësitë e FSK-së. Për arritje të jashtëzakonshme u nderuan kadetët: Ermira Statovci, për arritje akademike, Donjeta Krasniqi, për standard të lartë të udhëheqjes, Ilir Huruni, për disiplinë, Emir Rexhepi, për arritje të standardit të fitnesit fizik dhe Visar Havollit iu dha çmimi i Komandantit.
Rreshteri Ramë Klinaku u shpall instruktori më i dalluar dhe u nderua me mirënjohje për angazhimin e tij gjatë mbajtjes së këtij kursi.

Batalioni i Tretë i BRSH-së, kryen trajnimin "Gjenerimi i Forcës"



Pas një trajnimi katër mujor të ashtuquajtur "Gjenerimi i Forcës" të Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, në Mitrovicë, zyrtarisht u bë certifikimi i 92 pjesëtarëve të këtij batalioni.
Trajnimi është mbajtur në kazermën e Batalionit të Tretë nga instruktorët e KFOR-it turk dhe është udhëhequr nga major Ahmet Neasuhoglu.
Trajnimi u karakterizua me ushtrimet në terren, ku ndër temat kryesore që u trajnuan ishin: pozicionet e qitjes, çmontimi dhe montimi i armës, formacionet lëvizëse, navigimi, marshimi teknik dhe administrativ, ndërtimi i kampit, patrullimet etj.
Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë; zëvendëskomandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, shefi i mentoruesëve në KFT, kolonel Omer Faruk Asturk, nënkolonel Arsim Shaqiri, kapiten Nuri Ëshek dhe oficerë të tjerë të FSK-së dhe KFOR-it.
Zëvendëskomandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, me këtë rast, falënderoi ekipin e instruktorëve të KFOR-it turk për kontributin e dhënë, gjithashtu uroi të certifikuarit për angazhimin e tyre dhe arritjen e rezultateve të shkëlqyeshme gjatë trajnimit.
Kapiteni Nuri Ëshek, instruktor i KFOR-it turk, falënderoi pjesëtarët e stafit komandues të BRSH-së për bashkëpunimin dhe seriozitetin e treguar në përkrahje të këtij trajnimi, ndërsa pjesëtarët e FSK-së të cilët u certifikuan i uroi për arritjen e rezultateve gjatë trajnimit.
Në fund të ceremonisë, përfaqësues të KFOR-it turk ndanë mirënjohje dhe dhurata për pjesëtarët e dalluar të FSK-së gjatë këtij trajnimi.
Po ashtu, komandanti i Batalionit të Tretë, nënkolonel Arsim Shaqiri, ndau mirënjohje për instruktorët e KFOR-it turk, për angazhimin e tyre profesional gjatë stërvitjes, "Gjenerimi i Forcës" , me pjesëtarë të BRSH-së.

Diplomon gjenerata e dytë e nënoficerëve të FSK-së



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kursit të nënoficerëve, gjenerata e dytë për vitin 2013.
Kursin e kanë ndjekur 29 pjesëtarë me gradën tetar dhe rreshter dhe është realizuar nga instruktorët e KDS-së. Kursi ka zgjatur tetë javë dhe përmban 13 module të kombinuara nga pjesa teorike dhe praktike. Disa nga modulet kryesore janë: Koncepti zhvillimor i nënoficerëve, Udhëheqja ushtarake, Trajnimi fizik, Teknikat e ligjërimit, Shkathtësitë e komunikimit, Rregullorja rreshtore etj.
Gjithashtu, është realizuar edhe një ushtrim fushor dyditor në hapësirën e kazermës "Skënderbeu"në Ferizaj.
Për realizimin e këtij kursi, kontribut të jashtëzakonshëm me mbajtjen e ligjëratave për nënoficerë kanë dhënë ushtarët e KFOR-it amerikan, gjerman, italian dhe slloven.
Në ceremoninë e certifikimit të nënoficerëve morën pjesë; komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Bondstillit, kolonel Black Storey, si dhe oficerë tjerë të FSK-së dhe KFOR-it.
Komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi, me këtë rast, tha se zhvillimi i nënoficerëve gradualisht po merr formën e duhur, ngase më herët, kur ka filluar të realizohet ky kurs, janë përdorur standarde të ndryshme të marra nga shtete të NATO-s, ndërsa tash përdorim vetëm një standard i cili është kompletuar duke bashkëpunuar me instruktorë të NATO-s, ku kemi standardizuar programin unik i cili edhe po e lehtëson punën e instruktorëve, por edhe të vetë kadetëve.
Ndërsa, nënkolonel Di Marcio, përfaqësuesi i mentoruesve të NATO-s, në KDS, tha se angazhimi i pjesëtarëve të FSK-së në këtë trajnim është për t'u admiruar.
Pjesëtarët e kursit treguan përkushtim të madh në arritjen e rezultateve të mira, për çka unë i përgëzoj dhe njëkohësisht i porosis që të vazhdojnë me të njëjtin angazhim edhe nëpër njësitë e tyre. Në fund të kursit për arritje të shkëlqyeshme u ndanë 5 çmime për kadetët më të dalluar: Për arritje akademike u nderua, tetar Kujtim Alshiqi, për arritjen e standardit të lartë të udhëheqjes, tetar Halit Zahiti, për disiplinë tetar Metë Lajqi, për arritje të standardit në fitnesin fizik, tetar Feti Prronaj dhe tetari Agron Nura u nderua me çmimin e Komandantit.
Ky kurs po realizohet me sukses që nga viti 2009.

FORCA JONË

* * * Viti II • Nr. 14 • Korrik 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Nënshkruhet Marrëveshja për Bashkëpunim në mes të FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Sllovenisë

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës Agim Çeku, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Sllovenisë, z. Jakiq, më 11 qershor qëndroi për një vizitë zyrtare në Slloveni. Me këtë rast ministri Agim Çeku dhe ministri i Mbrojtjes së Sllovenisë Roman Jakiq, nënshkruan Marrëveshjen për Bashkëpunim në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në mes të ministrive të dy vendeve.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është që të ofrojë një kornizë bashkëpunimi midis dy ministrive brenda kufijve të kompetencave të parashikuara nga legjislacioni përkatës kombëtar dhe në përputhje me parimet e ligjit ndërkombëtar dhe praktikës ndërkombëtare.

Sipas marrëveshjes fushat në të cilat do të bashkëpunojnë këto dy ministri janë: siguria dhe stabiliteti ndërkombëtar; edukimi dhe trajnimi; planifikimi dhe financimi; logjistika; çështjet juridike; çështjet mjedisore si dhe fushat tjera të bashkëpunimit dypalësh.



Me këtë rast, ministri i FSK-së, Agim Çeku tha se, Sllovenia është një shembull i mirë i bashkëpunimit dhe gjithçka që vjen nga ky vend, populli i Kosovës e vlerëson shumë.

Ndërsa, ministri i Mbrojtjes së Sllovenisë, Roman Jakiq ka thënë: "ne jemi të hapur t'i shkëmbejmë përvojat tona dhe premtoj ta ndihmojmë FSK-në me çka do që ju nevojitet juve. Ne jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë sepse Kosova është prioriteti ynë".

Gjatë qëndrimit në Slloveni, ministri Agim Çeku u prit edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Sllovenisë, gjeneral brigade Dobran Bozhiq. Ministri Agim Çeku me delegacionin e FSK-së, vizituan edhe Akademinë Ushtarake ku, përmes një prezantimi, u njoftuan me punën e Qendrës së shkollave ushtarake; Komandën e Doktrinës, Edukimit e Trajnimit si dhe Qendrën e Trajnimit për Mbrojtje dhe Ndihmë Civile të Republikës së Sllovenisë.

Gjeneral Kadri Kastratit nderohet me Medaljen për Merita të Veçanta nga Garda Kombëtare e Aiovës



Komandant i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, u nderua me medalje për Merita të Veçanta nga Garda Kombëtare e Aiovës e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në emër të Gardës, medaljen gjeneral Kastratit ia dorëzoi Adjutanti i Përgjithshëm i Gardës Kombëtare, gjeneral major Timoty Orr.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, kanë marrë pjesë, komandanti i Gardës Kombëtare gjeneralmajori Orr dhe stafi më i lartë i Gardës Kombëtare të Aioves, si dhe stafi shoqërues i komandantit të FSK-së gjeneral Kastratit, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, major Fadil Hoxha si dhe atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në SHBA, gjeneral brigade Xhavit Gashi.

Gjeneral Kastrati gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pati një varg takimesh me personalitet më të larta ushtarake, dhe njëherit përcolli ushtrimin e përgjithshëm të Gardës Kombëtare të Aiovës, mbajtur, në Aiova dhe në Dakotën Veriore, (në këtë ushtrim morën pjesë edhe 11 pjesëtarë të FSK-së), etj.

Komandanti i FSK-së, mori pjesë edhe në ceremoninë e diplomimit të nënkolonelit të FSK-së, Agron Bajramit, në Qendrën e Armeve të Kombinuara të Ushtrisë së SHBA-ve, në Fort Leavenworth të shtetit të Kanzasit.

Në këtë bazë të madhe ushtarake të SHBA-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati u prit nga zëvendëskomandanti i Përgjithshëm i Qendrës së Armeve të Kombinuara gjeneralmajori Gordon B. Davis, me të cilën biseduan për bashkëpunimin në mes të kësaj Qendre ushtarake dhe FSK-së. Gjithashtu, komandanti i FSK-së u prit edhe nga zëvendëskomandanti i Përgjithshëm i Gardës Kombëtare të SHBA-së, për Qendrën e Armeve të Kombinuara-Fort Leavenworth, gjeneralbrigade Victor J. Braden i cili e njoftoi komandantin e FSK-së, përmes një prezantimi për historikun dhe të arriturat e Gardës Kombëtare. Në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gardën Kombëtare të Aiovës për ndihmën që po japin për FSK-së

Britania e Madhe konfirmon vazhdimin e mbështetjes për FSK-në

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku priti në takim zëvendësshefin për Politika Bilaterale për Evropën Veriore, zonjën Debbie Brothers, ambasadorin e Britanisë së Madhe në Prishtinë, Ian Clif, z. Carol Bell si dhe atasheun ushtarak, nënkolonel Col Osment.

Ministri Agim Çeku dhe zonja Debbie Brothers diskutuan për zhvillimet në Forcën e Sigurisë së Kosovës që nga formimi dhe për të arriturat e deritashme. Ministri Çeku po ashtu e njoftoi zonjën Brothers për misionin e FSK-së dhe vizionin e saj, për të ardhmen, si dhe falënderoi atë për mbështetjen që Anglia i ka dhënë FSK-së deri me tani, dhe njëherësh kërkoj nga ajo që kjo mbështetje të vazhdojë edhe më tutje dhe të thellohet edhe më shumë.

Delegacioni nga Mbretëria e Bashkuar e përgëzoi ministrin Çeku, për të arriturat e FSK-së dhe punën e mirë të Ministrisë për FSK-në, që është bërë deri me tani dhe premtoi së Britania edhe më tutje do ta mbështesë FSK-në në të gjitha projektet e saj.

Gjithashtu delegacioni nga Mbretëria e Bashkuar u prit edhe nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Gjeneral Kastrati e njoftoi zëvendësshefin për Politika Bilaterale për Evropën Veriore mbi strukturën, misionin dhe mbi angazhimet për ngritjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së.

Në dy takimet u konfirmua nga të dyja palët bashkëpunimi i ngushtë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Gjeneralbrigade Bashkim Jashari ka qëndruar për vizitë zyrtare në Pentagon

Gjeneral brigade Bashkim Jashari, Inspektor Gjeneral i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) me bashkëpunëtorë, ka qëndruar për një vizitë zyrtare pune në SHBA, që nga data 17-19 qershor 2013.

Gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjeneral Bashkim Jashari ka realizuar disa vizita të rëndësishme në Pentagon, Washington D.C. si dhe në selinë e Agjencisë së Inspektorit Gjeneral të Ushtrisë së SHBA-ve.

Gjenerali Bashkim Jashari është pritur nga Inspektori Gjeneral i Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjenerallejtënant Peter M. Vangjeli me të cilin ka pasur një takim të veçantë, kokë më kokë, ku kanë biseduar për modalitet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve: Agjencisë së Inspektoratit Gjeneral të ushtrisë së SHBA-ve dhe Inspektoratit të FSK-së.

Delegacioni i FSK-së është pritur edhe nga Stafi i Agjencisë së Inspektoratit të Shteteve të Bashkuara si dhe stafi i Shkollës së Inspektorëve të Ushtrisë së SHBA, të kryesuar nga komandanti i saj, kolonel James Brandon.

Vizita është vlerësuar nga të dy palët si shumë e suksesshme e cila do t'i paraprijë thellimit të bashkëpunimit të dy institucioneve, në çështjet me interes të përbashkët në fushën e inspektoratit.

Delegacioni i FSK-së është shoqëruar edhe nga Atasheu i Republikës së Kosovës në SHBA, gjeneral brigade Xhavit Gashi.

Ministri Çeku promovoi paqen në Konferencën e Ministrave të Mbrojtjes së Ballkanit

Ministri i FSK-së Agim Çeku mori pjesë në Konferencën e Ministrave të Mbrojtjes të Ballkanit, "SHBA-Karta e Adriatikut 5", me temën "Së bashku drejtë paqes dhe sigurisë globale" që u mbajt në Ohër të Maqedonisë më 13-14 qershor 2013.

Gjatë fjalës së tij në këtë konferencë ministri Çeku u shpreh se, në kuadër të gatishmërisë së Kosovës për të kontribuar për angazhime të përbashkëta për paqe, FSK-ja ka zhvilluar kapacitete të ngritura profesionale si: Njësi të Kërkim - Shpëtimit, Deminimit, Mjekësisë, etj. Ministri Çeku në kuadër të fjalës së tij tha se Kosova dhe FSK-ja janë të gatshme që të kontribuojnë dhe promovojnë paqen dhe sigurinë globale duke ofruar përvojat, njohuritë si edhe ekspertizat tona.

Ministri i FSK-së, gjithashtu tha se kur përmendet paqja, kjo nuk është vetëm një fjalë në letër për paqen, por duhet ngritur një themel i fortë i një bashkëpunimi rajonal dhe ndër nacional. Ai me këtë rast shprehu gatishmërinë që, në një të ardhme të afërt, Kosova të jetë anëtare me të drejta të plota në kuadër të "SHBA-Karta e Adriatikut".



Duke përfunduar fjalën e tij, ministri Agim Çeku tha se Kosova sikurse edhe vendet tjera anëtare të "Adriatikut 5", ka aspirata dhe qëllime të njëjta që të jetë mbështetëse aktive dhe kontribuuese për sigurinë Euro-Atlantike.

Në konferencën e ministrave të Mbrojtjes morën pjesë: ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kroacisë, Ante Kotromanoviq, zëvendësministrja e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, Arta Musaraj, si dhe ministra, zëvendësministra dhe ambasadorë të vendeve të rajonit.

Pjesë e delegacionit të Ministrisë së FSK-së, ishin edhe ushtruesi i detyrës i shefit të Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, nënkolonel Hasan Hoxha, këshilltarja politike e ministrit, Besa Kabashi- Ramaj si dhe atasheu ushtarak i SHBA-ve në Kosovë, kolonel Gjejms Kott. Në fund ministrat e vendeve anëtare të "SHBA-Karta e Adriatikut", nënshkruan një deklaratë të përbashkët.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë Arta Musaraj vizitoi MFSK-në



Zëvendësministrja e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë Arta Musaraj me bashkëpunëtorë ka vizituar Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), ku është pritur nga ministri Agim Çeku me bashkëpunëtorë. Me këtë rast ministri Agim Çeku dhe zv/ministrja Arta Musaraj biseduan për zhvillimet e gjithëmbarshme në fushën e sigurisë, për thellimin e bashkëpunimit si edhe për strategjinë në fushën e mbrojtjes, si qasje e re "Mbrojtjen Inteligjente" (Smart Difence), e cila po aplikohet në mes të dy shteteve në rajon, pra Shqipërisë dhe Kosovës.

Zëvendësministrja Arta Musaraj shprehu gatishmërinë dhe mbështetjen e plotë të Ministrisë të Mbrojtjes të Shqipërisë, për përkrahjen e FSK-së në procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë(RSSS), proces në të cilin është përfshirë Kosova aktualisht ndërsa Republika e Shqipërisë ka përvojë në RSSS është zv/ministrja Musaraj, po ashtu është angazhuar edhe në çështjen e integrimit të grave në strukturat e sigurisë, përderisa është përgjegjëse edhe për implementimin e Rezolutës 1325 të OKB-së.

Zëvendësministrja Arta Musaraj dhe zëvendësministri i FSK-së, Bejtush Gashi, pas takimit vizituan Komandën e Forcave Tokësore(KFT) të FSK-së, ku u pritën nga komandanti i saj gjeneralmajor Rrahman Rama, Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj (KDS) ku u pritën nga gjeneral brigade Enver Cikaqi.

Në të gjitha takimet të dyja palët konfirmuan bashkëpunimin në mes të dy ministrive.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati vizitoi Gardën Kombëtare të Ajovës

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjatë qëndrimit zyrtar të tij, në SHBA, u takua edhe me komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Timoti Orr, në kampin Dogj në Des Moines, të Ajovë-s, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në takimin e përbashkët ndërmjet dy gjeneralëve u bisedua për procesin e vazhdueshëm të bashkëpunimit ndërmjet të dy institucioneve: FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Po ashtu komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kastrati i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli vizituan dhe ndoqën nga afër ushtrimin fushor "Operacionet vjetore trajnuese" të Gardës Kombëtare të Aiovës.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjithashtu ka vizituar edhe pjesëtarët e FSK-së të përfshirë në këtë ushtrim, si edhe pesë pjesëtarë të tjerë që po marrin pjesë në Qendrën e Menaxhimit të Krizave në Kampin Dogj, në Des Moines.

Komandanti i FSK-së me stafin e tij, më datë 13 qershor 2013, ka marr pjesë në ceremoninë e diplomimit të nënkolonel Agron Bajramit, në Kampin Fort Leavenworth-Knazas City.

Kosova dhe Ajova janë në partneritet që nga viti 2011. Sidomos Garda e Ajovës e ka ndihmuar dhe po e ndihmon ngritjen profesionale të FSK-së, me një varg trajnimesh.



Nënkolonel Agron Bajrami diplomoi në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Armatës Amerikane

Më 14 qershor 2013, nënkolonel Agron Bajrami, diplomoi në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Armatës Amerikane (KKSHAA), me bazë në Leavenworth, Kansas. Agroni është oficeri i tretë i FSK-së i cili me sukses po i kryen trajnimet në këtë kolegj.

Kolexhi i Komandës dhe Shtabit të Armatës Amerikane është gurthemel i Institucionit Akademik Ushtarak për zhvillimin e oficerëve të gradës së mesme të FSK-së, me alumni, duke shërbyer në pozitat kyçe në FSK dhe duke ndihmuar në formësimin e Forcës brenda saj. Me rastin e diplomimit të nënkolonel Agron Bajramit, mori pjesë edhe Komandant i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendës komandant i Forcave Tokësore. Kjo ishte pjesëmarrja e parë e stafit të lartë të FSK-së, në ceremoninë e diplomimit të liderëve të lartë të FSK-së.

Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Armatës Amerikane është program me kohëzgjatje 10 muaj i cili ofron udhëzime në: udhëheqje, historinë ushtarake, filozofinë, planifikimin ushtarak si dhe marrjen e vendimeve. Ndjekja e kësaj shkolle është financuar nga programi ndërkombëtar për edukim dhe trajnim ushtarak nga Departamenti i Shtetit Amerikan. Kjo është realizuar në koordinim nga Zyra e Mbrojtjes dhe Bashkëpunimit të Ambasadës dhe Komandës Evropiane të SHBA-ve. Çdo vit përfitojnë dy oficerë të FSK-së nga ky program.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Fjalimi i plotë i ministrit Çeku në konferencën "SHBA- Karta e Adriatikut"

Të nderuar mysafirë, kolegë dhe miq, zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë e veçantë të marrë pjesë në këtë konferencë ministrore të Kartës Adriatike të SHBA dhe të takohem me miq të mirë dhe kolegë. Do të doja të falënderoja ministrin e Mbrojtjes së Maqedonisë Talat Xhaferi për ftesën e tij për pjesëmarrje në konferencë dhe mundësinë për t'ju drejtuar.

Si përfaqësues i Republikës së Kosovës në këtë konferencë të ministrave të mbrojtjes, do të doja ta përsëris shpresën e shtetit tim që në të ardhmen e afërt Kosova të bëhet anëtare, me të gjitha të drejtat e Kartës së Adriatikut të SHBA-ve. Kosova, si të gjitha shtetet e tjera të cilat e kanë nënshkruar Kartën Amerikano-Adriatike për partneritet, aspiron të njëjtin qëllim- të jetë mbështetëse aktive dhe kontribuuese e sigurisë Euro-Atlantike.

John Kennedy ka thënë që paqja është proces ditor, javor dhe mujor duke i ndryshuar vazhdimisht opsionet, duke i pakësuar ngadalë pengesat e vjetra dhe ndërtuar qetë strukturat e reja. Në Kosovë ne po përpiqemi ta bëjmë këtë- në po përpiqemi të kontribuojmë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e paqes me veprimet tona, zgjedhjet dhe qëndrimin tonë.

Sot, do të doja t'ju referohem disa çështjeve dhe t'ju ofroj përgjigje konkrete në pyetje që ju mund t'i keni sot. Së pari, cila është politika e sigurisë së Kosovës dhe çfarë është duke bërë Kosova për t'i zbatuar politikat e veta për të kontribuar në paqen dhe sigurinë globale?E dyta, çfarë mund të ofroj Kosova për ta ngritur sigurinë globale?Dhe në fund, çfarë po pret Kosova nga partnerët e saj regjionalë në rrugën drejt qëllimit tonë të përbashkët- paqja dhe siguria e vazhdueshme.

Kosova është e përkushtuar në procesin që na sjellë të gjithëve drejtë paqes dhe sigurisë globale. Ne do të vazhdojmë të punojmë ngushtë me aleatët dhe partnerët tanë për t'i kontribuar regjionit dhe botës me paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm.

Kosova shtet i pavarur prej pesë vitesh tani ka mundësi ta përmbush rolin e saj në rajon përmes bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes konstruktive. Në dëshirojmë të jemi vendi që kontribuon në paqen globale dhe stabilitetin. Kjo nuk është ambicia, por thjeshtë detyra jonë.

Kur flasim për paqen, të gjithë jemi të vetëdijshëm që ajo kërkon shumë më shumë së vetëm fjalët në letër. Paqja duhet të ndërtohet mbi themelet e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Bazuar në këtë të vërtet të thjeshtë, është logjike qe një prej prioriteteve kyçe të politikave të jashtme të Kosovës është zhvillimi i bashkëpunimit rajonal. Jemi më të efektshëm kur punojmë së bashku.

Si shtet, Kosova ka vuajtur në përvojat e dhimbshme të luftës, prandaj ne jemi të vendosur për të bërë çfarëdo që nevojitet për ta parandaluar që ajo histori të mos përsëritet. Përvoja e popullit tim e vërteton të vërtetën universale që e vetmja zgjidhje për paqen e qëndrueshme është pajtimi dhe bashkëpunimi që rrënjoset në respekt dhe besim.

Republika e Kosovës, sikur edhe të gjitha shtetet tjera demokratike, është e vendosur që të kontribuoj për një botë më të mirë ku të gjithë të ndihen të siguritë dhe të mbrojtur. Ne jemi të gatshëm të promovojmë paqen dhe sigurinë globale duke i ofruar përvojat tona, mësimet e nxjerra, diturinë dhe ekspertizën tonë. Ne kemi ekipe të shkathëta dhe profesionale të kërkim-shpëtimit, ekipet të deminimit, ekipe mjekësore dhe specialistë të tjerë. Forca e Sigurisë së Kosovës tanimë është zbarkuar në Shqipëri për të ofruar mbështetje pas fatkeqësisë natyrore Ne jemi gati të ofrojmë mbështetjen tonë prapë kurdo që paraqitet nevoja.

Kur e shikojmë situatën e tanishme në botë, ne shohim që luftërat dhe konfliktet vazhdojnë të shfaqen në pjesët e ndryshme të botës. Bashkësia ndërkombëtare ballafaqohet me sfida në luftën kundër terrorizmit , sulme kibernetike dhe shtimin e armëve të shkatërrimit masiv.

Këto sfida kanë krijuar një mjedis të sigurisë krejtësisht të ri dhe asnjë shtet nuk mund të merret me të i vetëm. Si rezultat i kësaj, një bashkëpunim më i afërt dhe një qasje holistike, drejtë sigurisë globale, janë të domosdoshme.

Kosova është e bindur që Ballkani Perëndimor mund të shërbej si shembull që përmes dialogut mund të arrihet besimi reciprok; konfliktet mund të zgjidhen në mënyrë paqësore përmes negociatave dhe siguria rajonale mund të realizohet përmes bashkëpunimit.

Në emër të Kosovës, i inkurajoj të gjithë që t'i shumëzojmë kapacitetet tona individuale dhe t'i bashkojmë ato. Nuk mund të lejojmë më që t'i harxhojmë kot burimet tona. Në vend të kësaj në duhet t'i bashkojmë ato për të mirën e përbashkët.

Ne jemi më efektshëm nëse punojmë së bashku. Kosova ju fton për një bashkëpunim më të thellë dhe më të plotë, për politika dhe doktrina të përbashkëta, për veprime dhe vendime të bashkërenduara, për përpjekje dhe kapacitete të kombinuara. Ky do të jetë çelësi i suksesit tonë. Ky do të jetë çelësi i ëndrrës tonë- paqja dhe stabiliteti i qëndrueshëm.

"NATO në Kosovë-Kosova në NATO", ligjëratë e ministrit Çeku në Fakultetin Filozofik



Në 14-vjetorin e fillimit të intervenimit të NATO-s, kundër forcave ushtarake të Serbisë, ministri i FSK-së Agim Çeku, para profesorëve dhe studentëve të Fakultetit Filozofik, të Universitetit "Hasan Prishtina" të Prishtinës, mbajti një ligjëratë, me temën: "NATO në Kosovë-Kosova në NATO", organizuar nga dekanati i Fakultetit Filozofik. Interesimi i studentëve dhe profesorëve të Fakultetit Filozofik, për të dëgjuar ligjëratën e ministrit Çekut, ishte aq i madh sa në amfiteatrin e këtij fakulteti nuk pati vende të lira për të pranishmit. Fillimisht rektori i Fakultetit Filozofik, Bujar Dugolli, përshëndeti ministrin Agim Çeku dhe falënderoi për mbajtjen e kësaj ligjërate, me interes të veçantë për studentët e këtij fakulteti, në përvjetorin e 14 të intervenimit të NATO-s në Kosovë.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, në fjalën e tij tha; "Është rast i mirë që edhe një herë të falënderojmë NATO-n, për gjithë mbështetjen që i ka dhënë dhe po i jep Kosovës. Integrimi në NATO është objektiv dhe dëshirë e Kosovës. NATO për ne, është më shumë se sa një Aleancë Ushtarako-Politike, ajo është simbol i lirisë, pavarësisë, sigurisë dhe mbrojtjes tonë".

Ndërsa, për sukseset e NATO-s, ministri Çeku, tha; "Ishte lufta e parë e fituar nga 19 shtete të aleancës, dhe gati asnjëra pre tyre nuk ka pasur interesa të drejtpërdrejta të veta në Kosovë. Ishte një luftë e bazuar mbi parimin se respektimi i të drejtave të njeriut është më i rëndësishëm sesa respektimi i integritetit dhe sovranitetit të shtetit Serb". Ministri i FSK-së, Agim Çeku, foli edhe për mësimet e nxjerra nga kjo fushatë ajrore, "edhe pse nuk duhet të jetë model për krizat e mundshme në të ardhmen", duke vazhduar më tej ai tha se, "të gjithë e dinin se Millosheviqi kishte vendosur ta zgjidhte problemin "një herë e përgjithmonë" që me luftë të ndryshonte balancën etnike në Kosovë dhe të shkatërronte UÇK-në. Këtë e dëshmoi edhe fushata ushtarake që ndërmori Serbia, siç ishte Operacioni "PATKOI". UÇK-ja u bë pjesë e zgjidhjes vetëm në fund të vitit 1998 pasi që ajo u ringjall dhe me ardhjen e misionit verifikues bashkësia ndërkombëtare e kishte situatën më të qartë në terren. Fushata filloi me NATO-n në krye të operacionit me ndihmën e SHBA-ve.Me sulmet ajrore nuk synohej shkatërrimi i potencialit ushtarak të Millosheviqit, por dobësimi i vullnetit të tij, për t'i rezistuar presionit të bashkësisë ndërkombëtare". Ministri Çeku, pastaj u ndal te fazat e operacionit të NATO-s, që kishin për qëllim, fillimisht: shkatërrim e sistemit kundërajror, komandës, kontrollit dhe komunikimit, etj.

Ndërsa mundësia që NATO të intervenojë edhe me forca tokësore paraqiste një rrezik të madh për forcat serbe. Forcat e NATO-s vetëm se ishin të zbarkuara në Maqedoni dhe Shqipëri për të zhvilluar misionin paqeruajtës në Kosovë, pas përfundimit të luftës. Plani i NATO-s për invazion tokësor ishte i koduar me emrin B. Në ligjëratën "Kosova në NATO-NATO në Kosovë", ministri Çeku i veçoi 4 çështje të rëndësishme: Pse Kosova aspiron të anëtarësohet në NATO; Pse Kosova ende nuk është në NATO; Çka duhet të bëj Kosova për t'u bërë anëtare e NATO-s; Cila është rruga që duhet ta ndjekim. Me anëtarësim në NATO e në shumë organizata dhe institucione botërore, duke kontribuar në siguri, shteti fiton miq, respekt, kurajë, krenari, etj. Ministri Çeku, u ndal edhe në temën: Pse nuk jemi në NATO? Për të shtuar se NATO, deri më tani, ka vetëm raporte operacionale me Kosovën, 4 vende janë neutral ndaj statusit, të cilat ende nuk na kanë njohur; Kosova ende nuk ka kapacitete ushtarake për të kontribuar në NATO, Kosova nuk paraqet urgjencë se nuk ka alternativë tjetër; Kosova nuk është anëtare e OSBE-së. Ai foli edhe për rrethanat e brendshme politike në Kosovë, perceptimi për Kosovën, ku shtjelloi gjerësisht këto tema. Në fund ministri i FSK-së, Agim Çeku foli edhe për objektivat strategjike të politikave të reja të partneritetit të NATO-s, si dhe profesionalizimin e FSK-së dhe të ardhmen e saj. Studentët e këtij fakulteti i bënë shumë pyetje, ministrit Çeku, që kishin të bënin me të ardhmen e FSK-së.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati përcolli zhvillimet e ushtrimit ushtarak "Adriatic Strike 2013"

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë, ka qëndruar për vizitë në Sllloveni, me rastin e zhvillimit të ushtrimit ushtarak "Adriatic Strike 2013", që u mbajt nga data 3-7 qershor.

Pjesëmarrës në stërvitjen e përbashkët ishin njësitet e Forcave të Armatosura të Kroacisë, Austrisë, Hungarisë, Italisë dhe ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ndërsa në cilësinë e vendeve vëzhguese ishin edhe Mali i Zi, Serbia dhe Vendet e Dialogut Mediteran.

Ushtrimi "Adriatic Strike 2013" është një stërvitje ku njësitë e misioneve paqeruajtëse zhvillojnë



dhe avancojnë kapacitetet e veta në mënyrë që t'i ngrehin në nivel më të lartë aftësitë reaguese në beteja, si edhe të jenë të aftë që të punojnë bashkërisht me partnerët. Komandanti i Forcës Sigurisë së Kosovës, gjeneral Kastrati së bashku me gjeneralë të vendeve të rajonit, me këtë rast, ndoqën ushtrimin nga afër si dhe panë aftësitë reaguese të ushtarakëve të vendeve pjesëmarrëse në ushtrimin " Adriatic Strike 13" në Sllloveni.

FSK-ja më e suksesshmja në stërvitjet e përbashkëta të ushtrive të rajonit

Dy njësi të specializuara për kërkim-shpëtim të Forcës së Sigurisë së Kosovës, më 2 qershor 2013, janë dislokuar nga kazerma "Adem Jashari" për të marrë pjesë në ushtrimin fushor-rajonal, "Joint reaction" në Republikën e Shqipërisë dhe në ushtrimin "Shared Risillience" në Republikën e Maqedonisë. Në këto ushtrime kanë marrë pjesë ushtritë e rajonit nga: Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Para nisjes për të marrë pjesë në këto ushtrime, Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i njoftoi pjesëtarët e FSK-së për rëndësinë e këtyre ushtrime të përbashkëta dhe kërkoi prej tyre të japin angazhimin maksimal dhe të përfaqësojnë FSK-në mënyrën më të mirë dhe dinjitoze dhe kërkoi rangimin më të lartë në vlerësimin e këtyre ushtrimeve.

Në ushtrimin "Joint Reaction 13" në Shqipëri, FSK-ja mori pjesë më 25 pjesëtarë, kurse në ushtrimin "Shared Resilience 13 " në Maqedoni, mori pjesë me 11 pjesëtarë.

FSK-ja më e suksesshmja në ushtrimin "Joint Reaction 2013"

Në ushtrimin e koduar "Joint Reaction 2013", të mbajtur në Zall-Herr të Republikës së Shqipërisë, nga data 2-7 qershor, mori pjesë edhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK)Në këtë ushtrim morën pjesë ushtritë e vendeve të rajonit: Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi dhe Kosova.

Drejtori i Drejtorisë së Operacioneve në Ministrinë e FSK-së, gjeneral brigade Zymer Halimi, ka thënë se FSK-ja në ushtrimin e koduar "Reagimi i përbashkët 2013", po merr pjesë me një tog të kërkim-shpëtimit dhe me oficerë të tjerë, të cilët janë të angazhuar në Task Forcën e përbashkët në nivel batalioni dhe në nivel kompanie. Togu i Task Forcës së FSK-së, veproi me profesionalizëm në terrenet e rrëpirëta të maleve të Bovillës, për kërkimin-shpëtimin e pasagjerëve, ku sipas skenarit ishte rrëzuar një aeroplan, në bordin e të cilit kishte 30 pasagjerë.

"Kjo është një eksperiencë e jashtëzakonshme për ne", tha gjeneral Halimi, "për arsye se realizohen të gjitha procedurat standarde operative që praktikohen nga shtetet anëtare të NATO-s, andaj edhe trupat tona, janë në këtë ushtrim duke i praktikuar të gjitha këto procedura standard. Siç e patë edhe ju, gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e FSK-së ishin të barabartë me ushtritë pjesëmarrëse nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Shqipëria"

Ndërsa drejtori i Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kolonel Edison Zarka, ka thënë: "Forca e Sigurisë së Kosovës ka demonstruar një nga stërvitjet më të mira që kemi zhvilluar këtë vit. Sapo pamë një nga skenarët e përgatitur për këtë stërvitje "Joint Reaction 2013" e cila ishte një stërvitje në kuadrin e vendeve të A-5, që janë të përfshira në rajonin tone". Ai shtoi se "ishte një demonstrim i trupave në terren, në nivel kompanie, por duhet të them se kjo stërvitje ishte një harmonizim i mirë i Qendrës së Simulimit që kemi në Komandën e Doktrinës dhe elementet që i kemi në forcat tona. Synimi kryesor i stërvitjes ka qenë të rrisim ndërveprimin e forcave tona, të kemi procedura standarde të punës, bazuar në standardet e NATO-s dhe të vijojmë bashkëpunimin edhe në fushat e tjera të sigurisë, për të mirën e rajonit dhe më gjerë", përfundoi Zarka.

Ushtrimi "Joint Reaction 2013" do të vazhdojë aktivitetin deri më 7 qershor.

Për ta përcjellë ushtrimin "Joint Reaction 2013", morën pjesë edhe komandanti i BMO-së, kolonel Ilaz Dërguti, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Shqipërisë, gjeneralmajor Viktor Berdo, komandanti i Forcës Tokësore të Shqipërisë gjeneralmajor Zyber Dushku, si dhe përfaqësues të ushtrive pjesëmarrëse, atashe ushtarakë si dhe përfaqësues të NATO-s, etj.



FSK-ja pjesë e ushtrimit të përbashkët "Shared Resilience 13"

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) përfundoi me sukses stërvitjen kryesore në ushtrimin e përbashkët "Shared Resilience 13", që u mbajt në Pepelishtë të Republikës së Maqedonisë, nga data 27 maj deri me 7 qershor të këtij viti.

Në përmbyllje të këtij operacioni ishin të pranishëm edhe delegacionet e ministrive të Mbrojtjes të vendeve pjesëmarrëse. Në këtë stërvitje, përveç vendit nikoqir, Republikës së Maqedonisë e cila ishte edhe e organizatore e kësaj stërvitjeje, morën pjesë edhe kontingjentet nga Sllovenia, Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi.

Ushtrimi fushor "Shared Reseilence 13" u realizua duke u bazuar në skenarë të operacioneve për t'u përballur me fatkeqësi natyrore dhe ndihmë humanitare, nën përkujdesjen e NATO-s, Komandës së Bashkuar Amerikane për Evropë dhe Kombeve të Bashkuara (UN), në të cilin u demostrua ndërveprimi i ushtrive dhe organizatave tjera në regjion.

Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i Forcave Tokësore të FSK-së, i shoqëruar nga kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, shef i Departamentit Mjekësor në Ministrinë e FSK-së dhe kolonel Gjejms Kot, atashe amerikan pranë Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë, ishin në mesin e personaliteteve të ushtrive të vendeve pjesëmarrëse të cilat vizituan pjesë të këtij operacioni.

Gjeneral Hazrolli, përgëzoi kontingjentin e FSK-së, të përbërë nga pjesëtarë të Kompanisë së Mjekësisë dhe të Task Forcës së Kërkim-Shpetimit, për rezultatet e treguara, për motivimin e lartë dhe përkushtimin gjatë kryerjes së detyrave.

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi u shpreh i kënaqur me rezultatet e arritura të kontingjenteve pjesëmarrëse dhe me theks të veçantë foli për rolin dhe suksesin e treguar të kontingjentit të FSK-së në ushtrimin "Shared Resilience 13". Ministri Xhaferi tha gjithashtu se bashkëpunime me Kosovën, përkatësisht me Ministrinë e FSK-së është i shkëlqyeshëm dhe i terë bashkëpunimi është i përcaktuar edhe me marrëveshjen dypalëshe ndërmjet dy ministrive.

Gjatë demostrimeve në poligonin ushtarak në Pepelishtë të Republikës së Maqedonisë u inskenuan një varg skenarësh të cilat kërkuan reagimin e ushtarakëve pjesëmarrës; ndër to evakuime mjekësore, trajtime mjekësore në spitale fushore, kërkim-shpëtim, evakuime me helikopter etj.

Gjatë këtij muaji, FSK-ja, përkatësisht kontingjentet saja ,kanë marrë pjesë në beso lloj ushtrime dhe stërvitje jo vetëm në Republikën e Maqedonisë por edhe në Republikën e Shqipërisë. Këto ushtrime dhe stërvitjet nëpër të cilat po kalojnë njësitë e FSK-së në operacione të përbashkëta kanë tregues se FSK-ja është partner i suksesshëm me kapacitete reale reaguese.

Kadetët e FSK-së dëshmuan standarde të larta profesionale në stërvitjen "Kampi veror 13"

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), Shemsi Veseli i shoqëruar nga gjeneralmajor Rrahman Rama, zëvendëskomandant i FSK-së dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore dhe gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, vizituan ushtrimin "Kampi veror 13". "Përpjekja gjithëpërfshirëse e kombinuar për ndërtimin e paqes", mbajtur në poligonin ushtarak "Krivollak" të Republikës së Maqedonisë, në të cilin për dhjetë ditë u stërvitën kadetët e FSK-së.

Zëvendësministri i FSK-së Shemsi Veseli u shpreh tepër i lumtur për rezultatet e arritura të kadetëve të FSK-së, në kuadër të "Kampit veror 13" dhe i uroj ata për rezultatet e arritura gjatë stërvitjes duke shtuar se çdo ditë e më shumë FSK-ja po tregon që ka të ngritur gatishmërinë dhe se sprovat e tilla si kjo, në këtë ushtrim, po tregojnë që FSK-ja po aplikon standarde të NATO-s dhe se gjatë zbatimit në praktikë po tregon se është në pajtueshmëri me ushtritë me të cilat është në partneritet.

Ndërsa, ministri i Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, me këtë rast tha: " Fryma e bashkëpunimit dhe e gatishmërisë së kadetëve pjesëmarrës në ushtrim është e jashtëzakonshme. Unë i përgëzoj kadetët e FSK, për kualitetet që po tregojnë në këto ushtrime të përbashkëta".

Stërvitjen përfundimtare të ekzekutimit të ushtrimit e realizuan bashkërisht si një trup, kadetët e FSK-së, të ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Britanisë së Madhe, Malit të Zi, Maqedonisë dhe ata të Ushtrisë së Bullgarisë.

Në poligonin ushtarak "Krivollak" ishte i pranishëm ministri Mbrojtjes i Republikës së Maqedonisë Talat Xhaferi si dhe përfaqësues të ministrive të Mbrojtjes të vendeve pjesëmarrëse në ushtrim.

Objektivi i përgjithshëm i "Kampit veror 13" ishte që të sjellë në praktikë me anë të stërvitjeve, sfidat komplekse të operacioneve në konflikt dhe pas konflikteve, operacionet që kadetët pjesëmarrës- luftëtarë të ardhshëm të paqes mund të përballën në të ardhmen.









Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Armata e Suedisë deminuan Parkun e Gërmisë

Mbi 25000 mijë metra katror janë pastruar nga Kompania e Deminimit të FSK-së dhe Armata e Suedisë, në Parkun Gërmia. Deminerët e FSK-së kanë shkatërruar 35 bomba kasetore dhe tri granata dore.

Togeri Kadri Shabani, komandant i Togut të Katërt, të Kompanisë së Deminimit, ka thënë se në pastrimin e Gërmisë, punët i kanë kryer së bashku me Armatën e Suedisë. "Ne kemi punuar së bashku me Armatën e Suedisë, që nga 2 prilli i këtij viti dhe kemi pastruar mbi 25000 mijë metra katror, dhe këtu, kemi gjetur dhe shkatërruara 35 bomba kastore dhe 3 granata dore, dhe kemi bërë bartjen e mbeturinave të ndërtesës së shkatërruar, mbi 445 kamionë-mbeturina"



Ministri i FSK-së Agim Çeku, fillimisht ka falënderuar Qeverinë e Suedisë si dhe Armatën e Suedisë, për ndihmën që po i jep FSK-së, dhe për njësitin e specializuar "Gote" të Armatës së Suedisë, që kanë ndihmuar me makineri të rëndë, në pastrimin e kësaj fushe, të mbetur që nga pas lufta. Ne që nga pas lufta e kemi bërë pastrimin Gërmisë, përveç kësaj pjese, për mungesë të ekskavatorëve të blinduar. Sot Gërmia është e sigurt për të gjithë qytetarët tanë që e vizitojnë këtë bukuri të rrallë. Ne jemi shumë me fat, që kemi miq të shumtë, siç është Suedia e cila na ka ndihmuar me një njësitë të specializuar "Gote" dhe ne gjithmonë do të jemi falënderues për ndihmën e ushtrisë së Suedisë, si dhe të gjithë qytetarët tanë, do ta falënderojnë në mënyrë të veçantë FSK-në dhe Ushtrinë e Suedisë, për pastrimin e Gërmisë.

Ndërsa, ambasadorja e Suedisë në Prishtinë, zonja Ingrid Johanson, përkujtoi se shumë herë, ka vizituar Gërminë, dhe ka vërejtur shiritat me shenjat për rrezikun nga minat, dhe kjo çdoherë më ka brejtur. Sot, jam shumë e lumtur, që ma në fund u pastrua kjo pjesë e Gërmisë, dhe për këtë e falënderoj FSK-së dhe Ushtrinë e shtetit tim, për punën e madhe që kanë bërë së bashku. Dhe jam e bindur se kësi projektesh mund të punojmë së bashku edhe më tej, në të ardhmen, shtoi në fund ambasadorja Suedisë, zonja Ingrid Johanson.

Deminerëte FSK-së dhe Ushtrinë e Suedisë i falënderoi edhe kryetari i Prishtinë, Isa Mustafa.

Në ceremoninë e përmbylljes së deminimit të Gërmisë, morën pjesë edhe zëvendësministri i FSK-së Shemsi Veseli, komandanti i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralbrigade Imri Ilazi,atasheu ushtarak i ambasadës së SHBA-së, në Prishtinë, koloneli Kott, si oficerë të lartë të FSK-së, të KFOR-it, dhe zyrtarë të Komunës së Prishtinës.

Azemina Cullum nderohet me mirënjohje nga Ministria e Administratës Publike

Për nder të 23 qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Shërbyesve Civilë, Ministria e Administratës Publike ka dhënë mirënjohje për punëtorët e dalluar që shërbejnë në të gjitha ministritë e Qeverisë së Kosovës.

Nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës me mirënjohje"Për punën dhe kontributin e dhënë në fushën e administratës publike, për periudhën 2012-2013", është nderuar zn. Azemina Çulum, shefe e Zyrës për Komunitete në MFSK.

Me rastin e pranimit të mirënjohjes, nga ministri i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Yagcilar, Azemina Çulum falënderoi të gjithë ata që e kanë përkrahur dhe ndihmua në realizimin e detyrave të përditshme. Me këtë rast, në veçanti, ajo falënderoi ministrin e FSK-së, komandantin e FSK-së, të gjithë kolegët e saj, komunitetet në Kosovë, ambasadat dhe ekipin e NATO-s, për mbështetjen që i kanë dhënë gjatë punës së saj. Ndër të tjera ajo tha: " Suksesi i punës sime është i lidhur me ta dhe varet prej tyre, sepse puna në MFSK është sfiduese, kërkon shumë angazhim, kërkon mund dhe kreativitet; për këtë, ndonjëherë ndjehem sikur po jap edhe tepër prej vetes dhe jetës sime private, por ndjenja e lumturisë dhe ndjenja që kam arritur t'i bëj disa ndryshime në institucion, në komunitete, ndryshime të cilat do t'i lë pas dhe të cilat janë të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës, ia vlejnë që të sakrifikohesh dhe të përpiqesh për to. Gjatë kryerjes së detyrë sime në këtë pozitë, si femër, nuk kam pasur kurrfarë vështirësish; përkundrazi, jam inkurajuar, më kanë dhënë fuqi dhe ky shpërblim është dëshmia më e mirë e respektit ndaj femrës dhe punës së saj, në ministrinë tonë. Kjo mirënjohje për mua është motivim i ri, për punë edhe më profesionale dhe më cilësore në të ardhmen, natyrisht është motivim edhe për kolegët e mi të cilët më përkrahën vazhdimisht"tha me këtë rast zn. Azemina Çulum.



Konferencë rajonale për transformimet ushtarake në rajon



Nën organizimin e Forumit për Siguri (grup i organizatave joqeveritare), më 7 qershor 2013, në Prishtinë, u mbajt konferenca rajonale për transformimet ushtarake, e ku morën pjesë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga vendet e rajonit, si: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.

Ministri i FSK-së Agim Çeku, mbajti referatin për transformimet ushtarake dhe politikat e mbrojtjes në rajon.

Ai foli gjerësisht për transformimet ushtarake dhe politikat e mbrojtjes në përgjithësi, ndërsa, në veçanti për të arriturat e FSK-së dhe të ardhmen e saj.

Ministri Agim Çeku ka shtjelluar etapat historike të transformimeve ushtarake në botë, ndërsa është ndalur në transformimet pas rënies së Murit të Berlinit, si dhe krijimin e ushtrive të vendeve të rajonit pas luftërave në ish-Jugosllavi. "FSK-ja, është forcë e ndërtuar sipas standardeve të NATO-s, dhe në përgjithësi ka arritur t'i plotësojë të gjitha kapacitet operacionale, për të cilat tani presim vetëm konfirmimin nga ana e NATO-s. Kjo do të ndodhë shumë shpejt, ndërsa tani jemi në proces të rishikimit të sektorit të sigurisë. Këtu nuk do të kemi më transformim, por vetëm do t'i zgjerojmë detyrat, dhe do t'i shtohen FSK-së kapacitetet dhe detyrat që i mungojnë", ka thënë Çeku.

Ministri Çeku, paraprakisht foli për transformimin e UÇK-së në TMK, ngritjen dhe profesionalizimin e saj; shkollimin dhe krijimin e Akademisë Mbrojtëse të TMK-së etj.

Konferenca i vazhdojë punimet në seancën e dytë, me temën; për procesin e integrimit në NATO. Konferencën e hapi Nazim Haliti, koordinator i Forumit për Siguri, i cili fillimisht ka thënë se çështjet ushtarake nuk janë tema të përditshme, andaj kjo konferencë rajonale synon të vështroj arritjet e FSK, por dhe zhvillimet dhe transformimet ushtarake të vendeve të rajonit.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Ahmet Isufi, në fjalën e tij përshëndetëse ka thënë, se "jemi me fat që NATO ka qenë që nga fillimi e përfshirë në ndërtimin e FSK-së".

Konferenca i ka vazhduar punimet në tri sesione, dhe ka shqyrtuar këto tema: "Transformimet ushtarake dhe politikat e mbrojtjes", "Procesi i integrimit në NATO", Bashkëpunimi ushtarak rajonal në mes vendeve tona.

Në konferencë temat e etyre i kane shtjelluar edhe Jelena Miliqi, drejtoreshë e Qendrës për Studime Euro-Atlantike nga Serbia, Aleksandar Dedoviq, drejtor i Alfa Centar nga Mali i Zi, Martin Pechijareski, hulumtues në Institutin për Demokraci Sociale-Progres, nga Maqedonia, Sotiraq Hroni drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim nga Shqipëria, Armin Krzhaliq, drejtor i projektit në Qendrën për Studime të Sigurisë nga Bosnja e Hercegovina, Kastriot Frashëri, drejtor i Institutit për Çështje Kombëtare nga Shqipëria etj.

Konferencën e kanë ndjekur zyrtarë nga MFSK, FSK, MPB, Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Ambasada Amerikane, Ambasada Suedeze, OSBE, ICITAP, KFOR, Ekipi Këshillues i NATO-s, studentë të kolegjit ISPE, dhe pjesëtarë të shoqërisë civile.

Ministri Agim Çeku panelist aktiv në konferencën "Future of NATO's Partnership"

Ministri i Forcës së Sigurisë, Agim Çeku me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Malit të Zi, mori pjesë në forumin "Future of NATO's Partnership"), që u mbajt nga data 6 - 8 qershor 2013, në Budvë të Malit të Zi.

Ministri Çeku pati rol aktiv në panelin e forumit dhe mbajti një ligjëratë me temën: "Momentumi për Kosovën dhe Serbinë- Implikimet regjionale".

Temat tjera që u ligjëruan në këtë forum ishin edhe:"Ngritja e Turqisë në Ballkan", "Bashkëpunimi dhe partneriteti ndërmjet shërbimeve të inteligjencës civile dhe ushtarake" etj.

Gjatë viteve 2011 dhe 2012 në forumin e njëjtë, që ishte organizuar nga Ministria e Mbrojtjes së Malit të Zi dhe Këshillit Veri-Atlantik, kanë diskutuar personalitete të larta si: senatori i SHBA-ve John Mçain, gjeneral Miechislav Bienek etj.

Ahmet Isufi, ligjëroi në KDS

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Ahmet Isufi, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së, në Ferizaj, ka mbajtur një ligjëratë me temë "Sistemi i sigurisë" e cila zgjoi interesim të madh te oficerët dhe nënoficerët e KDS-së.

Zotëri Isufi elaboroi në tërësi disa aspekte të funksionimit të FSK-së dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pastaj foli për kontrollin dhe organizimin e këtyre institucioneve, funksionimin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, rrugën drejt integrimit në strukturat euroatlantike, lidhjet me Këshillin e NATO-s, etj.

Kryetari i Komisionit për Siguri u përgjigj edhe në pyetjet e oficerëve dhe nënoficerëve të KDS-së, për çështjet aktuale të sigurisë si dhe avancimin e sigurisë së Kosovës në këtë drejtim.

Intervistë me pjesëtaret e FSK-së, nëntoger Mimoza Budeci dhe Manushaqe Nura

Oficeret më të suksesshme të FSK-së në Akademinë Ushtarake Mbretërore të Anglisë

Mimoza Budeci dhe Manushaqe Nura janë oficeret më të suksesshme të FSK-së në Akademinë Ushtarake Mbretërore të Anglisë. Andaj po shpalosim për herë të parë periudhën e tyre që nga koha kur ishin kadete të FSK-së e deri më tani si oficere të kësaj force.

Se si vendosën të jenë pjesë e FSK-së, të dy nëntogeret kanë mendime pothuajse të ndryshme, Për Mimozën kjo ishte një ëndërr e kamotshme. " Unë gjithmonë kam besuar në ëndrra dhe në realizimin e tyre. Elonor Rosevelt ka thënë se e ardhmja ju takon njerëzve që besojnë në bukurinë e ëndrrave të tyre". Kurse për Manushaqen ideja që t'i shërbej vendit i lindi gjatë periudhës së luftës së fundit. "Të jem pjesë e FSK-së ka qenë një vendim që është marrë nga unë në vitin 1999, ku jam frymëzuar nga situata e atëhershme në trojet shqiptare. Prandaj, si fëmijë u betova që kur të rritem do të bëhem ushtare e Kosovës, që askush të mos guxojë ta sulmojë atdheun tim. Ky betim ka jetuar me mua deri në ditën kur unë vendosa të bëhem pjesë e kësaj ushtrie" Për t'i realizuar ëndrrat e tyre që të dyja zgjodhën Qendrën për Studime Universitar (QSU-në), ku tregojnë me kënaqësi për periudhën 4 vjeçare që kanë kaluar gjatë shkollimit në këtë Qendër, si një ndër periudhat më të mira dhe më të paharruara në jetën e tyre. Kanë përfunduar edhe studimet në Universitetin Amerikan në Kosovë, Manushaqja ka kryer drejtimin Teknologji Informative, Komunikim në Media dhe Grafik, si dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, kurse Mimoza ka kryer studimet në drejtimin Menaxhim dhe Politika Publike. Për Mimoza Budecin jeta e një kadeti në Akademi Ushtarake është e mbushur plotë me sfida, obligime dhe vështirësi, por në fund ndjenja e kënaqësisë dhe krenarisë që e merr si rezultat i përfundimit të studimeve është shumë e vlefshme dhe e paharrueshme. Po ashtu edhe për Manushaqe Nuren, jeta e një kadeti është shumë dinamike dhe me sfida të ndryshme. Është një jetë me disiplinë maksimale që të zhveshë pothuajse komplet nga jeta civile. Nga kadetët e FSK-së kërkohet angazhim maksimal dhe përqendrim total në jetën ushtarake. Megjithatë, edhe pse është profesion shumë kërkues i ka momentet e veçanta që vetëm kadetët i kanë përjetuar, gjë që e bëjnë këtë jetë shumë interesante dhe i bënë kadetët



shumë unik si në FSK ashtu edhe në shoqëri në përgjithësi."Edhe pse profesioni ynë është shumë serioz mund të them që shakatë dhe momentet më interesante të jetës sime i kam përjetuar si kadet. Andaj u rekomandoj të gjitha vajzave që e duan këtë profesion të mos hezitojnë por ta provojnë dhe ta realizojnë ëndrrën e tyre. Jeta e një ushtaraku është e mbushur me sfida dhe e bazuar në parime që kanë vetëm një qëllim, shërbimin sa më dinjitoz ndaj shtetit dhe popullit" është shprehur Budeci, duke shtuar se ky është i vetmi profesion me të cilin ajo ndjehet plotësisht e përmbushur në jetë. Edhe për Manushaqen dedikimi i ushtarakëve për të jetuar me shtatë vlerat ushtarake e bëjnë ushtarakun të dallohet nga civilët". "Unë jam shumë e lidhur me profesionin e ushtarakut. Këtë profesion mund ta ndërroi vetëm atëherë nëse kontributi im për Kosovën vlerësohet më i rëndësishëm në ndonjë fushë tjetër" shtoi Nura. Në pyetjen tonë se a ndjehen të paragjykuara në profesionin e tyre ? Ato përgjigjen njëzëri se nuk kanë vërejtur asnjë lloj paragjykimi apo diskriminim. Nëntoger Budeci thotë: "Unë si oficere gëzoj një trajtim të kënaqshëm, por sigurisht se ka hapësirë për përmirësime në fushën e trajtimit të gjinisë femërore në FSK. Ndërsa nëntoger Nura duke përdorur shprehjen e vjetër "Atë që mbjell, do të korrësh", ajo inkurajon të gjitha pjesëtaret e FSK-së që të mos hezitojnë të raportojnë të gjitha rastet e diskriminimit, duke luftuar maksimalisht për të drejtat e tyre. Gjatë periudhës sa kanë qenë kadetë dhe tash që janë duke u shkolluar në Akademinë Ushtarake Mbretërore të Anglisë ato kanë pasur arritje të jashtëzakonshme. Mimoza na flet shkurt për arritjet e saj "Nuk janë të pakta, por jo aq sa për t`u vetëkënaqur. Të arriturat që unë i cilësoj si suksese janë: Përfundimi i Akademisë Ushtarake në Prishtinë, pastaj kam arritur që të fitoj bursën për të vazhduar shkollimin në Akademinë Ushtarake në Britani të Madhe, bursë kjo e cila nuk ka qenë e planifikuar të ofrohet fare, por për shkak të performances me është ofruar. Po ashtu në Britani të Madhe jam zgjedhur si kadeti më e mirë në shkollën e gjuhëve në fazën B, kam fituar medalje në garën për marshim dhe zgjedhje të problemeve të ndryshme (ushtarake), gjithashtu kam qenë e propozuar për t`u zgjedhur si kadeti më i mirë i huaj në Akademi" thotë Mimoza. Edhe për nëntoger Nurën të arriturat janë të shumta "Qysh nga Akademia Ushtarake në FSK kam arritur që të thyej ca barriera që për mua kanë qenë të rëndësishme. Po veçoj disa prej tyre: kam qenë rreshteri i parë femër që është caktuar si instruktore për trajnim në javën e ferrit të kadetëve të gjeneratës 2014. Kam qenë po ashtu edhe komandanti i parë femër i kadetëve të FSK me gradë kadet kapiten. Gjithashtu, në krosin e parë që është mbajtur në nivel të FSK-së kam zënë vendin e parë. Pas diplomimit në akademi jam përzgjedhur për të përfaqësuar Kosovën në Akademinë Ushtarake Mbretërore të Anglisë ku po vazhdoj punën me shumë kënaqësi. Gjatë studimeve në këtë akademi kamë fituar dy herë medalje në garat e vrapimit në terrene të pyllëzuara Cros Country. Medalja e parë ka qenë medalja e argjendtë ku si ekip jemi shpërblyer me medalje të argjendta për vendin e dytë në garën që mbahet në nivel të ushtrisë britaneze. Ndërsa medalja e dytë ka qenë medalja e artë në gara ekipore ku kemi marrë vendin e parë në ligën e Ushtrisë britaneze për të gjitha garat. Një shpërblim tjetër e kam marrë nga akademia, ku jam shpërblyer me shpërblimin Full Colours që është mirënjohje për kontributin e dhënë në akademi si kadet i kësaj akademie. Tani jam duke punuar shumë që në tre muajt e mbetur të akademisë të mundohem të arrijë edhe rezultate të tjera" thotë Manushaqja.

Dy nëntogerët e FSK-së, tashmë oficere të kësaj force, momentalisht janë duke u shkolluar në Akademinë Ushtarake Mbretërore të Anglisë dhe kanë treguar rezultate shumë të mira në të gjitha kategoritë. Madje ato janë të parat në listën e oficerëve më të suksesshëm. Për to përfaqësimi i FSK-së në këtë Akademi është privilegj dhe krenari. "Është ndjenje krenarie dhe njëherësh përgjegjësie që të arrijë ta përfaqësoj Kosovën në mënyrën më të mirë të mundshme." thotë Mimoza Budeci .

"Të përfaqësosh Kosovën në vendet e tjera sa është krenari po aq është edhe përgjegjësi, por nëse ju zgjidhni të përfaqësoni Kosovën në një profesion që ju e doni, atëherë nuk do të hasni në vështirësi. Do të jetë shumë atraktive për ju të punoni në mënyrë që të jeni një imazh sa më i mirë për të prezantuar vendin tuaj, por normalisht do të jeni e motivuar për të arritur shumë dhe për të sfiduar veten në profesionin që ju e doni. Si prezantuese e Kosovës në Akademinë Ushtarake Mbretërore të Anglisë kam pasur shumë kënaqësi që t'ju tregoj kadetëve britanez si dhe kadetëve të vendeve të ndryshme të botës që Kosova edhe pse vetëm 14 vite pas luftës, ka arritur të shkollojë oficerë që mund të krahasohen me oficerë të vendeve të zhvilluara evropiane, dhe ka qenë një mundësi shumë e mirë që të lobojmë për Kosovën tek njerëzit që në një të ardhme të afërt do të jenë njerëz me funksione të rëndësishme në shtetet e tyre." thotë Manushaqe Nura. Pas përfundimit në këtë akademi ato do të kthehen në njësitë e tyre në Forcën e Sigurisë së Kosovës në detyrat që u janë caktuar nga FSK-ja. Nëntoger Mimoza Budeci është Shefe e Laboratorit për Materie të Rrezikshme në Kazermën e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), të FSK-së, në Pomozotin, kurse nëntoger Manushaqe Nura është Udhëheqëse e Togut të Tretë në Task Forcë, në RMC, togë që është e gatshme të reagojë për kërkim- shpëtim në ujëra.

27 nënoficerë mbaruan kursin “Lider luftarak”



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve të kursit; Lideri luftarak, gjenerata 02/2013. Ky kurs u realizua nga instruktorë të FSK-së, të trajnuar dhe të licencuar në Akademinë e Nënoficerëve të Armatës së 7-të të Ushtrisë Amerikane, në Graefenwehr në Gjermani, mbështetur edhe nga instruktorët amerikan.

Në ceremoni e certifikimit, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, fillimisht prezantoi të arriturat e FSK-së, pastaj foli në përgjithësi për ushtrimet fushore dhe aktivitetet tjera, të cilat i ndërlidhi me trajnimet të cilat zhvillohen në kursin e Liderit luftarak. Gjeneral Kastrati kërkoi nga nënoficerët e certifikuar, që njohurit e fituara t'i përcjellin me besnikëri tek njësitet e tyre.

Ndërsa, zëvendëskomandantja e KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, pasi përshëndeti dhe falënderoi të gjithë për kontributin e dhënë, për realizimin me sukses të Kursit; Lideri Luftarak, tha, " ky kurs është një shembull i mirë i organizimit, i motivimit dhe është një obligim të cilin duhet ta kryejnë nënoficerët e FSK-së".

Koloneli Ray Wojcik, nga Ambasada Amerikane, tha se ndjehet i lumtur që pjesëtarët e FSK-së kanë arritur të adaptojnë kursin në këtë nivel kaq të lartë dhe shprehi gatishmërinë për bashkëpunim të mëtutjeshëm. Ndërsa, rreshter majori Allen Dall, tha: "ne jemi duke bashkëpunuar në realizimin e kursit të liderit luftarak dhe kjo është një dëshmi se pjesëtarët e FSK-së, janë duke punuar me përkushtim të lartë në drejtim të marrjes dhe shpërndarjes së dijes në njësitë e tyre".

Kursin Lideri Luftarak e kanë kryer 27 pjesëtarë të nivelit tetar, rreshter dhe kapter.

Në fund u dhanë mirënjohje për pjesëtarët më të dalluar si dhe certifikata për të gjithë kadetët pjesëmarrës.

Kadetët më të dalluar u shpallën: Tetar Bukurie Namani, të cilës i takoi çmimi, " ushtar i dalluar", tetar Zenel Shalës, çmimi "për udhëheqje", tetar Fatmir Januzit, çmimi, "ushtari i hekurt", tetar Rasim Plakaj, "çmimi i Komandantit" dhe gjithashtu u shpallën edhe instruktorët më të dalluar: Tetar Arben Sallahu dhe tetar Bashkim Berisha.

Në ceremoninë e certifikimit mori pjesë edhe zëvendëskomandanti i KFT-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe të KFOR-it.

30 pjesëtarë të komuniteteve filluan "Kursin Bazik" në KDS



Ministri i FSK-së, Agim Çeku së bashku më zëvendësministrin Sllavisha Filipoviq, komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandantin e FSK-së gjeneralmajor Rrahman Rama të shoqëruar edhe nga oficerët lartë kanë qëndruar për një vizitë pune, në Komandën Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në Ferizaj. Delegacioni u prit nga komandanti i KDS-së, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, i cili e njoftoi ministrin për mbajtjen e "Kursit Bazik" të rekrutëve të rinj, nga radhët e minoritarëve, gjenerata e parë për vitin 2013. Këtë kurs janë duke e vijuar 30 pjesëtarë të komuniteteve, prej të cilëve; njëzetë e gjashtë janë serbë, dy boshnjak, një turk dhe një ashkali.

Gjatë vizitës në Qendrën e Stërvitjes Bazike, ku janë duke kryer Kursin Bazik, ministri Çeku uroi rekrutët e rinj për pranimin në FSK, i përgëzoi ata për vendimin e drejtë dhe të guximshëm për të ju bashkëngjitur FSK-së dhe njëherit kërkoi prej tyre angazhim maksimal, me qëllim të realizimit të programit të kursit dhe plotësimit të standardeve të përgjithshme që ka FSK-ja.

"Për këtë, ne jemi këtu, për t'ju përkrahur në kërkesat dhe sfidat tuaja, dhe me juve po punojnë instruktorët më të përgatitur të FSK-së. Ne jemi shumë të interesuar që ju të mësoni dhe t'i realizoni me sukses të gjitha programet dhe standardet e FSK-së, me qëllim që t'i shërbeni të gjithë qytetarëve që jetojnë në Kosovë, dhe të vazhdoni karrierën tuaj ushtarake duke avancuar deri në gradat më të larta".

Fillim të mbarë dhe suksese në trajnime, regrutëve të rinj, u ka dëshiruar edhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ndërsa, zëvendësministri i FSK-së Slavisha Filipoviq, i ka inkurajuar regrutët për punë, për angazhim, për përkrahje dhe ka kërkuar nga të arrijnë suksese të përgjithshme.

Certifikohen edhe 153 pjesëtarë të rezervës aktive të FSK-së

Më 14 qershor 2013, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, u organizua ceremonia e certifikimit të 153 pjesëtarëve të rezervës aktive të FSK-së, gjenerata e dytë e viti 2013, të cilët përfunduan kursin bazik të trajnimeve.

Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë zëvendësministri i MFSK-së Bejtush Gashi, gjeneralmajor Rrahman Rama, zëvendëskomandant i FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandant i KDS-së dhe kolonel Vinchenzo Matina, përfaqësues nga mentoruesit e NATO-s.

Pjesëtarët e rezervës aktive, me rastin e certifikimit, i përshëndeten zëvendësministri Bejtush Gashi, gjeneral Enver Cikaqi dhe kolonel Matina, të cilët i uruan pjesëtarët e rezervës aktive, për përfundimin me sukses të këtij kursi dhe njëherësh i uruan që trajnimet dhe detyrat në të ardhmen t'i kryejnë në strukturën e FSK-së, në të mirë të sigurisë të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe vendeve të regjionit.

Certifikimi edhe i 153 pjesëtarëve të rezervës aktive të FSK-së është aktivitet i vazhdueshëm drejtë kompletimit të formacionit të rezervës aktive të FSK-së, prej 800 pjesëtarëve, aq sa e parasheh ligji për FSK-në.





FSK-ja ndërtoi urën mobile mbi lumin Drin

Në aksin rrugor Klinë - Gjakovë të hënën është inauguruar ura provizore mbi lumin Drin në fshatin Kramovik të Gjakovës-Rahovecit, të cilën e kanë ndërtuar 30 pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, i ka përgëzuar pjesëtarët e FSK-së, të cilët e kanë bërë një punë të mirë me ndërtimin e urës, e cila ka përfunduar disa ditë para afatit të caktuar. "FSK-ja e bëri edhe një punë të mirë, u ndihmoi autoriteteve civile, në këtë rast komunën e Gjakovës, t'i japin zgjidhje problemit që i ka munduar ata, por edhe qytetarët e tyre në vendosjen e kësaj ure të përkohshme", është shprehur Çeku.


Ndërkaq Zejnullah Prokshi nga FSK-ja ka shpjeguar se si është ndërtuar ura dhe çfarë standardi ka. "Kjo urë për herë të parë është qitur nga pjesëtarët e FSK-së. Është e gjatë 55 metra, kurse e gjerë 5 metra. Pas vërshimeve të 18 marsit kemi dalë në vendin e ngjarjes për vlerësimin e situatës. Kemi vërejtur se mesi i urës aktuale ka lëvizur dhe shtylla bregore është dëmtuar dhe janë rrezikuar pjesëtarët", ka thënë Prokshi.

Për t'u vërtetuar se ura është e sigurt për të mbajtur pesha të rënda, së pari ka kaluar një kamion i FSK-së. Nga data 14 mars e këtij viti ura mbi lumin Drin u dëmtua nga prurjet e mëdha të ujërave.

FORCA JONË

* * * Viti II • Nr. 15 • Gusht 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministrat Çeku dhe Imami nënshkruan marrëveshjen SOFA



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës Agim Çeku dhe ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Arben Imami, më 1 korrik, kanë nënshkruan marrëveshjen SOFA. Kjo marrëveshje rregullon procedurat e hyrje-daljes, qëndrimin e përkohshëm dhe statusin e anëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe anëtarëve Forcave të Armatosura të Shqipërisë në territorin e shtetit përkatës, si dhe përbërësve civil apo personave në varësi.

Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes u mbajt në kazermën e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prizren. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm zëvendësministrat e FSK-së: Shemsi Veseli dhe Bejtush Gashi, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Kadri Kastrati, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA shqiptare, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të institucioneve përkatëse.

Ministri i FSK, Agim Çeku, pasi ka përshëndetur nënshkrimin e këtij dokumenti, u shpreh, se: "Sot u arrit një marrëveshje e rëndësishme mes shqiptarëve. Me ministrin Imami, mikun tim, nënshkruam marrëveshjen SOFA, e cila rregullon procedurat e hyrjedaljes, qëndrimit të përkohshëm dhe statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe anëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në territorin e shtetit përkatës, si dhe kompetencat dhe juridiksionet përkatëse. Kjo është një marrëveshje që i ka munguar dy vendeve tona, ajo është kulmi i bashkëpunimit shumë dinamik dhe shumë të frytshëm që e kemi pasur me Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë dhe Forcat e Armatosura dhe personalisht me z. Imami gjatë këtyre 4 viteve, një marrëveshje kjo që e kemi iniciuar të dy bashkë".

Ministri Çeku, theksoi se: "Ky është një rast shumë i mirë për ta falënderuar ministrin Imami për mbështetjen që i ka dhënë FSK-së, si një prioritet të punës së tij, në Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë". Ministri Çeku në emër të Ministrisë për FSK-në dhe në emër të FSK-së i dha ministrit Arben Imami, Medaljen për "Shërbim meritor", në shenjë respekti për punën, kontributin dhe ndihmën e pakursyer, në mbështetje të FSK-së.

Ndërsa, ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Arben Imami, pasi ka falënderuar të pranishmit dhe në veçanti ministrin Çeku, u shpreh: "Është një kënaqësi e veçantë, madje një nder, privilegj që vizitën time të fundit jashtë Republikës së Shqipërisë ta zhvilloj pikërisht në Kosovë. Këto katër vjet kanë qenë të rëndësishme për Ministrinë e Mbrojtjes, për FA dhe FSK dhe besoj se zhvillimet kanë qenë të rëndësishme dhe bashkëpunimi ka qenë i shkëlqyer, nga ku kjo marrëveshje kurorëzon shumë përpjekje dhe rrit shkallët e bashkëpunimit, por ajo çka është më e rëndësishme është standardi i NATO. Për Republikën e Shqipërisë, çështja e Sigurisë Kosovë - Shqipëri ka qenë për ne; një dhe e pandarë, por kjo çështje sigurie në kuadrin e sigurisë së NATO, bëhet akoma më e fuqishme duke i dhënë vendeve tona shansin për të ecur përpara në rrugën e integrimit dhe zhvillimit në mënyrë që këto dy vende dhe kombi shqiptar të jetë një komb i civilizuar. Shqipëria është një vend i NATO-s, Kosova një vend partner dhe nesër do të jetë pjesë e NATO-s. Në fund ministri Imami, tha: "Jam krenar që në këto katër vite, që janë vitet e para të anëtarësisë së Shqipërisë në NATO, ne kemi bërë gjithçka për të shkuar drejt këtyre qëllimeve dhe objektivave". Ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Imami u prit me nderime të larta shtetërore nga Togu Ceremonial i FSK-së.

Ministri dhe komandanti i FSK-së, takuan kundëradmiralin Patrick Piercey

Ministri dhe komandanti i FSK-së Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kanë prit më 30 korrik, në takime të ndara një delegacion të oficerëve të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Komandës së Bashkuar për Evropë (EUCOM) të kryesuar nga Kundëradmirali Patrik Pirsi (Patrick Piercey), zëvendësdrejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane (J-5) i cili shoqërohej edhe nga atasheu ushtarak i SHBA-ve në Kosovë, koloneli Gjems Kot (Jems Kott) si dhe oficerë të tjerë madhor pjesëtarë të delegacionit.

Ministri Çeku dhe komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati pasi e kanë falënderuar Kundëradmiralin Pirsi, për ndihmën e përgjithshme që po japin Shtetet e Bashkuara të Amerikës për Kosovën e në veçanti për FSK-në, ata potencuan bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që ka me Gardën Kombëtare të Ajovës, në fushën e shkollimit, trajnimeve dhe ngritjes profesionale të FSK-së. Ministri Çeku gjithashtu e ka njoftuar delegacionin Amerikan, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së; për përmbushjen e kapaciteteve operacionale, detyrat konkrete si dhe për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Nga ana e tij, kundëradmirali Amerikan, Patrick Pircey ka premtuar se edhe në të ardhmen do të vazhdojnë përkrahjen për FSK-në.



Parlamentarët gjermanë interesohen për FSK-në



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku, më 2 korrik, ka prit një delegacion të Parlamentit të Gjermanisë, kryesuar nga z. Rainer Erdel, shoqëruar nga ambasadori i Gjermanisë në Kosovë dhe atasheu ushtarak. Interesimi i Parlamentarëve Gjerman ishte të dinë më shumë për zhvillimet e përgjithshme politike, gjendjen e sigurisë në Kosovë, për rrugën e zhvillimit të FSK-së si dhe sfidat që e presin atë, në realitetin e ri politik dhe të sigurisë.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, me këtë rast, ka falënderuar Gjermaninë dhe popullin gjerman për ndihmën e përgjithshme që kanë dhënë dhe po japin për Kosovën e në mënyrë të veçantë në ngritjen e FSK-së. Ministri Çeku, parlamentarët gjermanë i njoftoi edhe me të arriturat e deritashme të FSK-së, orientimet strategjike zhvillimore të bazuara në rezultatet e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës (RSSSK). Me këtë rast, ai theksoi se objektiv i posaçëm i zhvillimit dhe bashkëpunimit më të madh në fushën e sigurisë në nivel regjioni dhe me gjerë, që Kosova nga konsumues i sigurisë të shndërrohet në kontribuues të sigurisë së përgjithshme. Ministri Çeku, rithekso se ky proces do të jetë transparent dhe konstruktiv i mbështetur në bashkëpunim të ngushtë me miqtë ndërkombëtar dhe strukturat e NATO-s.

Mysafirët shprehën konsideratë për arritjet e deritashme dhe shprehen interesimin e gjetjes së fushave me interes të përbashkët për të intensifikuar bashkëpunimin në mes ushtrisë gjermane dhe FSK-së. Delegacioni i Parlamentit Gjermanë, gjatë ditës së sotme, ka qëndruar për një vizitë edhe në Komandën e Forcave Tokësore, ku janë pritë nga gjeneralmajor Rrahman Rama.



Gjenerallejtënant Kadri Kastrati uron të gjithë pjesëtarët e FSK-së, me rastin e deklarimit të arritjeve të Kapaciteteve të Plota Operacionale

Të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të FSK-së,

Më 09 korrik 2013, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Anders Fogh Rasmussen, ka deklaruar se Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur Kapacitetet e Plota Operacionale dhe është plotësisht e aftë për kryerjen e detyrave të saj brenda mandatit që ka dhe standardeve të përcaktuara nga NATO. Arritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale është një sukses i radhës i FSK-së i arritur me përkushtimin, angazhimin, disiplinën dhe profesionalizmin e treguar nga të gjithë ju. Andaj, ju përgëzoj dhe ju uroj për këtë sukses të deklaruar nga NATO. Objektivi jonë kryesor është rrugëtimi drejt anëtarësimit në NATO dhe për të arritur këtë objektiv duhet të punojmë edhe më shumë në profesionalizimin e FSK-së.

Kërkoj nga ju që të angazhoheni edhe në të ardhmen, që sa më shpejtë të arrijmë edhe objektivin tonë kryesor, që FSK të evoluojë në forcë ushtarake e cila do të jetë një faktor paqeje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, rajonin dhe më gjerë

Urime e suksese!

Kadri KASTRATI
Gjenerallejtënant

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati është takuar me shefin e Ushtrisë së Malit të Zi, nënadmiralin Dragan Samargjiq

Zotohen për bashkëpunim të mëtutjeshëm

Më 16 korrik, në Ministrinë e FSK-së, për një vizitë zyrtare, qëndroi shefi i Mbrojtjes së Republikës të Malit të Zi, nënadmirali Dragan Samargjiq, i cili u prit nga komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati.

Për nder të Shefit të Mbrojtjes së Malit të Zi, ishte rreshtuar edhe Togu Ceremonial i FSK-së. Fillimisht, komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati bisedoi kokë më kokë me nënadmiralin Samargjiq, dhe pastaj vazhduan takimet e punës në mes të dy delegacioneve. Shefin e Mbrojtjes së Malit të Zi, nënadmiralin Samargjiq e priti edhe ministri i FSK-së Agim Çeku. Gjatë takimit të përbashkët ministri Agim Çeku dhe gjeneral Kadri Kastrati e kanë njoftuar Shefin e Mbrojtjes së Malit të Zi, me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe me plotësimin e kapaciteteve operacionale të FSK-së, ku kohë më parë e konfirmoi edhe zyrtarisht Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen. Gjatë takimit, gjithashtu u bisedua edhe për vazhdimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat që janë me interes jo vetëm për të dyja shtetet por edhe për sigurinë e rajonit.

Në konferencën e përbashkët për gazetarë, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati pos tjerash tha se; shefin e Mbrojtjes të Malit të Zi nënadmiralin Samargjiq, e njoftova për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për pjesëmarrjen në trajnimet e përbashkëta në nivel të rajonit, për rishikimin e sektorit strategjik të sigurisë si dhe për bashkëpunimin rajonal.

"Një prej prioriteteve tona është



ngritja e bashkëpunimit rajonal dhe se Forca e Sigurisë së Kosovës është një forcë në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Dëshirojë që të jetë forcë funksionale për rajonin dhe të jetë forcë, që në të ardhmen të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO dhe nga Kombet e Bashkuara.

Unë kërkova prej admiralit Samagjiq, në mënyrë që eksperienca e tyre t'i shërbejë FSK-së për rrugëtimin tonë drejt anëtarësimit në NATO. Gjithashtu e njoftova admiralin për të arriturat e FSK-së, si dhe për objektivat për vitin e ardhshëm dhe për rishikimin e sektorit strategjik të sigurisë.

Ne u pajtuam që në të ardhmen ta rrisim bashkëpunimin për të mirën e dy shteteve dhe të rajonit" shtoi në fund komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati.

Ndërsa, shefi i Mbrojtjes së Malit të Zi, nënadmirali Dragan Samargjiq tha se marrëdhëniet tona politike janë të mira dhe ne si ushtarak nuk kemi arsye përse të mos bashkëpunojmë në mes vete.

Unë gjithashtu e uroj gjeneral Kastratin për përparimet që ka bërë FSK-ja dhe më e mira; është plotësimi i kapaciteteve operacionale. Unë gjithashtu u njoftova edhe për objektivat e FSK-së, për vitin e ardhshëm e që FSK-ja po zhvillohet dhe po bëhet një faktor stabiliteti në rajon.

Po ashtu pata mundësinë që të bisedojë me ministrinë dhe gjeneral Kastratin për mundësit tona për bashkëpunim.

Objektivi i vendit tonë është anëtarësimi në NATO dhe në Bashkimin Evropian, mirëpo para së gjithash objektivi ynë është që të kemi marrëdhënie ndërmjet dy vendeve si dhe i gëzohem bashkëpunimit, që do të jetë për mirëqenien e të dyja vendeve.

Më pastaj, delegacioni i Ushtrisë së Malit të Zi, vizitoi edhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) së FSK-së, në Ferizaj, ku nënadmirali Samarxhiq vizitoi pjesëtarët e komuniteteve pakicë, në kursin e trajnimit bazik.

Muhamet Latifi, emërohet zëvendësministër i ri i FSK-së

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 8 korrik, u organizua një ceremoni pritjeje për zëvendësministrin e ri të FSK-së, z. Muhamet Latifi, si dhe përcjelljen e ish-zëvendësministrit, Shemsi Veseli, (emëruar në detyrë të re).

Me rastin e pranim-dorëzimit të detyrës të zëvendësministrave, ministri i FSK-së Agim Çeku ka falënderuar Shemsi Veselin për punën e deritashme në Ministrinë e FSK-së, dhe i ka dhënë Mirënjohje, për angazhimin e pakursyer dhe për kontributin e dhënë në FSK, ndërsa, zëvendës-



ministrit të ri, Muhamet Latifit i ka dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, njëherit i premtoi bashkëpunim të gjithanshëm në realizimin e detyrave në Ministrinë e FSK-së.

Ambasadori Cliff konfirmon mbështetjen e Britanisë së Madhe për FSK-në

Ministri i FSK-së Agim Çeku, më 15 korrik ka zhvilluar një takim pune, me ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, z. Jan Klif (Ian Cliff), me të cilën kanë biseduar për arritjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së. Ministri Çeku fillimisht e ka falënderuar Britaninë e Madhe për ndihmën e pakursyer që kanë dhënë dhe po japin për shkollimin, për trajnimet e pjesëtarëve të FSK-së, si dhe për ndihmën profesionale, përmes, këshilltarëve të Britanisë, për FSK-në.

Ambasadori i Britanisë së Madhe, z. Jan Klif, me këtë rast, e ka përgëzuar ministrin, komandantin si dhe të gjithë oficerët e FSK-së, për arritjen e kapaciteteve të plota operacionale të FSK-së, të deklaruar kohë më parë nga NATO. Gjatë konferencës me gazetarë, Ministri Çeku ka falënderuar të gjithë ushtarët, nënoficerët, oficerët e FSK-së, KFOR-it dhe të NATO-s, për angazhimin e tyre në përmbushjen e kapaciteteve të plota operacionale si dhe për kryerjen e detyrave sipas standardeve më të larta të përcaktuara nga NATO.

Ministri Çeku, gjithashtu, ka njoftuar se Britania e Madhe do të jetë e angazhuar ta ndihmojë FSK-në edhe pas njohjes së Kapaciteteve të Plota Operacionale.

Pas takimit ministri Çeku dhe ambasadori Klif dhanë deklaratë për media dhe u përgjigjen në pyetjet e gazetarëve.



Soren Jesen Petersen, përgëzoi ministrin Çeku, për të arriturat e FSK-së

Ministri i FSK-së Agim Çeku, më 16 korrik, priti në takim, ish kryeadministratorin e UNMIK-ut Soren Jesen Petersenin (Søren Jessen-Petersen). Me këtë rast, ministri Çeku e falënderoi ish- kryeadministratorin Petersen, për angazhimet e tij të pakursyera në të mirë të Kosovës, pra dhe pas shpalljes së Pavarësisë.

Ish-kryeadministratori Soren Jesen Petersen uroi ministrin Agim Çeku për arritjet e deritashme të FSK-së, duke vlerësuar lart deklarimin e NATO-s për njohjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO).

Ambasadori Stojan Karajanov, vizitë lamtumirëse në MFSK

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Agim Çeku, priti edhe ambasadorin e Republikës së Maqedonisë, në Republikën e Kosovës, zotëri Stojan Karajanov, në një vizitë lamtumirëse në MFSK, para se ai të largohet nga Kosova.

Ministri Agim Çeku, me këtë rast, e ka falënderuar ambasadorin Stojan Karajanov, për kontributin e dhënë në intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve, me theks në bashkëpunimin intensiv ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë.

Ndërkaq, ambasadori Stojan Karajanov ka shtuar se do të angazhohet edhe më tej për intensifikimin e bashkëpunimit në mes dy vendeve dhe midis MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Komandanti i Gardës Kombëtare të Aiovës qëndroi për një vizitë zyrtare në FSK

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kanë pritë në takime të ndara, më 2 korrik, komandantin e Gardës Kombëtare të Aiovës, gjeneralmajor Timoty Orr, me bashkëpunëtorë, atasheun ushtarak të SHBA-ve në Prishtinë, kolonel James Kott.

Ministri dhe komandanti i FSK-së, fillimisht e falënderuan gjeneralin Orr, për ndihmën e madhe që po jep në përgjithësi Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në veçanti Garda Kombëtare e Ajovës, për ngritjen profesionale të FSK-së.

Ministri Çeku me komandantin e Gardës Kombëtare të Aiovës, biseduan edhe për bashkëpunimin e mëtejmë në mes të dy institucioneve; Gardës Kombëtare të Ajoves dhe FSK-së, për veprimet konkrete si dhe zgjerimin e programit të partneritetit edhe në fusha tjera, në konceptin "Tërë Ajova për Tërë Kosovën", si dhe thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen dhe kontributi i stafit të Ajovës përmes Ambasadës Amerikane dhe përfaqësuesve të tyre, që janë pjesë të NAT-it.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, e njoftoj gjeneralin Orr, me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të veçantë, pjesëmarrjen e FSK-së, në ushtrimet rajonale të mbajtura në Shqipëri dhe Maqedoni, Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë si dhe për marrëveshjen e bashkëpunimit, dhe marrëveshjen-SOFA.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr, shprehu gatishmërinë që edhe në të ardhmen të vazhdojë me ndihmën e përgjithshme për FSK-në.



Në Gërmi, zbulohet pllaka e bashkëpunimit të FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Suedisë

Në Parkun e Gërmisë në Prishtinë, solemnisht u bë zbulimi i Pllakës në shenjë të bashkëpunimit në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Suedisë, të cilët gjatë muajit prill-qershor, kanë punuar së bashku në pastrimin e Parkut Gërmia, nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera, të cilat kishin mbetur që nga paslufta.

Zbulimin e pllakës e bëri zëvendësministri i FSK-së Muhamet Latifi dhe ambasadorja e Suedisë në Prishtinë, zonja Ingrid Johanson. Në këtë ceremoni merrnin pjesë edhe gjeneralbrigade Zymer Halimi, gjeneralbrigade Imri Ilazi, Haxhi Shala, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane në MFSK, atasheu ushtarak i Suedisë, kolonel Curt Jakobsson, Agim Gashi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike në komunën e Prishtinës si dhe oficerë të lartë të FSK-së.



Gjenerali Orr uroi FSK-në për ngritjen e urës mbi lumin Drini i Bardhë

Komandanti i Gardës Kombëtare të Aiovës (SHBA), gjeneralmajor Timoty Orr, gjatë qëndrimit në Kosovë, më 4 korrik, së bashku me komandantin e Komandës së Forcave Tokësore(KFT), gjeneralmajor Rrahmnan Rama kanë vizituar urën, mbi lumin Drini i Bardhë, të ngritur nga Njësiti i Xhenios i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) të FSK-së.

Komandanti i KFT-së, gjeneral Rama e njoftoi komandantin e Gardës Kombëtare të Aiovës, gjeneralin Orr, për mbështetjen e autoriteteve civile në infrastrukturë, siç është ura mbi lumin Drini i Bardhë, në Kramovik.

Për nder të Komandantit të Gardës Kombëtare të Aioves, gjeneralit Orr, afër urës mbi lumin Drini i Bardhë, ishte rreshtuar Njësiti i Xhenios, i cili me krenari po frekuentonte qarkullimin në mënyrë të sigurt të automjeteve dhe qytetarëve mbi urë, e cila para 15 ditëve ishte e paketuar, ndërsa tani kishe stolisur lumin si xherdan, përderisa kapiten Islam Haliti i njoftonte gjeneralët Rama dhe Orr, mbi procesin e montimit të urës dhe për punën e pakursyer të cilën e kanë kryer pjesëtarët Xhenios së FSK-së si edhe ata të mbështetjes, mjekësia, logjistika, transporti, etj.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Aiovës, gjeneral Timoty Orr, u shpreh se ndjehet tejet i lumtur që po sheh në terren vepra të xhenios së FSK-së, të cilat do t'u shërbejnë qytetarëve për lehtësimin e jetës së tyre. Gjenerali amerikan tha gjithashtu se edhe Garda Kombëtare e Aiovës shpesh ftohet nga komuniteti atje për të mbështetur autoritetet civile dhe se veprat e tilla janë në të mirë të të gjithë qytetarëve. Gjenerali Orr në shenjë admirimi për punën e shkëlqyer të pjesëtarëve iu dha atyre nga një shenjë të tij(cofin).

Në vizitë pos gjeneralit Rama dhe gjeneralit Orr ishin të pranishëm edhe Komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale, kolonel Ilaz Derguti, komandanti i Batalionit të Xhenios, nënkolonel Zenë Prokshi dhe Atasheu Ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë, kolonel James Kott.

Gjenerali Orr vizitoi edhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes

Komandanti i Gardës Kombëtare të Aiovës (Iowa), gjenerali Timothy Orr së bashku me Atasheun Ushtarak të SHBA-ve, në Kosovë, kolonel James Kott, në kuadër të vizitës që janë duke i bërë Kosovës, më 3 korrik, vizituan Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, ku u pritën nga gjeneralmajor Rrahman Rama, komandant i Komandës së Forcës Tokësore(KFT) dhe gjeneralbrigade Enver Cikaçi.

Delegacionin e lartë të Aiovës, me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, e njoftoi gjeneralmajor Rrahman Rama, si për shkollimin, trajnimin dhe stërvitjen e efektivave të FSK-së. Gjithashtu gjenerali Orr u interesua për zhvillimet në FSK, bashkëpunimin në shumë fusha që është duke zhvilluar FSK-ja me Gardën Kombëtare të Aiovës.

Me këtë rast, gjenerali Orr, vizitoi edhe Ushtrimin Vend Komandës(UVK), "Luani 2" me anë të të cilit KDS-ja është duke testuar aftësitë komanduese, reaguese dhe taktike të stafit. Gjithashtu, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, komandanti i Gardës së Shtetit Aiova, përcolli edhe ceremoninë e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kanë kryer kursin për mësimin e Gjuhës Angleze, ku u certifikuan kursantët e nivelit III-të, IV-të dhe ata të nivelit të V-të.



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së, në Ferizaj

Diplomuan dhe u graduan kadetët e FSK-së të gjeneratës së pestë

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, më 5 korrik, u mbajt ceremonia e diplomimit të kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare (QSU) të FSK-së, gjenerata e pestë, viti 2013.



Pas shfaqjes së posaçëshme (drill) të kadetëve, ministri i FSK-së Agim Çeku, mbajti fjalën tematike. Ai me këto fjalë iu drejtua kadetëve: "Të nderuar kadet, faleminderit për këtë pamje kaq të bukur që na dhuruat e cila na bën të gjithë neve të ndihemi krenarë me juve, kjo është një ditë e veçantë për juve, të cilën, do ta mbani ndërmend gjatë tërë jetës, kjo është një ditë, kur ju po e filloni karrierën e juaj ushtarake, dhe mos harroni; shumë Gjeneral me famë botërore, karrierën e tyre e kanë filluar me këso lloj ceremonie. Jam shumë i sigurt se para vetës, kam të rreshtuar edhe gjeneral të ardhshëm të Kosovës! Mundohuni që pikërisht, Ju të jeni ai", tha ministri i FSK-së Agim Çeku, për të shtua se:"kjo ceremoni të nxit ndjenja të veçanta; kur FSK-ja po rritet, po fuqizohet dhe ata ja dolën".

Në fund, ministri Çeku, kërkoi nga kadetët e posa diplomuar: "Kadet të nderuar, oficerë të rinj të vendit tonë, keni zgjedhë një profesion të veçantë, profesion shumë fisnik dhe të mrekullueshëm, por edhe profesion në të cilin ka shumë pak detyra të lehta. Ju gjatë punës dhe karrierës tuaj do të ballafaqoheni me sfida të mëdha, me probleme të mëdha, me situata të vështira, por, do të duhet të sakrifikoheni, të përjetoni edhe dhimbje të mëdha, kuptohet do të ketë edhe momente gëzimi, momente triumfi, do të ketë edhe festa, ceremoni por ato zakonisht kalojnë shpejt në harresë.

Por, vetëm ndjenja e suksesit, krenaria për përmbushjen e misionit, besimi dhe respekti që shfaqin vartësit e juaj, do të kompensojë vështirësitë dhe sakrificat që keni



që nga sot, asaj po i shtohen edhe këta oficerë të rinj, të shkolluar, të edukuar dhe të trajnuar sipas standardeve më të larta të NATO-s".

Ministri Çeku, për sukseset e kadetëve, falënderoi stafin e KDS-së, AUK-ut, dhe familjarët e kadetëve të cilët janë shumë meritor për suksesin e kadetëve.

"Të jeni të sigurt, që kadetët nuk do të ju harrojnë kurrë dhe do të ju marrin për shembull, çdo herë ku do të ballafaqohen me vendime, me sfida dhe me zgjedhje të vështira. Ju, nga viti në vit, po nxirrni gjenerata ma të mira, se gjeneratat paraprake. Akademia jonë ushtarake dhe sistemi i shkollimit të oficerëve të rinj, janë më të mirët në rajon. E di se sa krenar jeni sot me djemtë e juaj, por edhe kadetët edhe ne eprorët e tyre, jemi shumë mirënjohës sepse pa mbështetjen e juaj, pa inkurajimin e juaj, pa dashurinë e madhe tuajën, ndaj tyre; djemtë e juaj nuk do të ishin rreshtuar sot, këtu para nesh. E di se sa shumë mund, sakrifica, dashuri, inkurajim është dashtë të bëni për t'i mbështetur djemtë e juaj, që të ja dalin, dhe



bërë në përmbushje të misionit apo detyrës.

Ju do ta kuptoni ma mirë, thënien e njohur të Winston Churchillit:"Ne jetojmë nga ajo çka marrim, por e bëjmë jetën nga ajo që Japim"

Pra, puna e juaj, profesioni i juaj ka të bëj me dhënie. Gati gjatë tërë kohës nga ju do të kërkohet vetëm të jepni, që kurrë mos të lodheni, kurrë mos të ligështoheni dhe kurrë, bash kurrë, mos të dorëzoheni.

S'ka nevojë të ju them, se ju duhet të udhëhiqeni me shembullin tuaj. Ushtarët tuaj meritojnë komandim dhe udhëheqje të shkëlqyeshme, dhe ju duhet të ja ofroni këtë.

Nuk kam dyshim se Ju do t'i përmbushni pritjet tona.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjeneral lejtënant Kadri Kastrati pasi përshëndeti të pranishmit, tha: "Diplomimi i kadetëve të FSK-së, gjenerata 2013, është një moment sa i rëndësishëm aq edhe premtues për institucionin dhe për vendin tonë. FSK-ja gjatë këtyre viteve ka dëshmuar para opinionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar; gatishmërinë, përkushtimin dhe disiplinën për të përmbushur misionin e saj.

Janë arritur rezultate të larta, si në përmbushjen e kapaciteteve humane, teknike e infrastrukturore dhe në përgjithësi përmbushjen e kapaciteteve të plota operacionale.

Një ndër të arriturat e rëndësishme të FSK-së është ngritja dhe profesionalizimi i mëtejmë. E arritur e konsiderueshme dhe shumë e rëndësishme është edhe shkollimi i kadetëve në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, që kryhen sipas standardeve të NATO-së.

Oficerët e FSK-së janë krenaria jonë, jo vetëm për institucionin tonë, por, për Kosovën, ata janë prezantues të denjë të vlerave bashkëkohore ushtarake, ata kudo që kanë qenë pjesëmarrës, si në trajnime apo shkollime, brenda dhe jashtë vendit kanë treguar një shfaqje e cila në të shumtën e rasteve janë shpërblyer me mirënjohje dhe falënderime të ndryshme nga institucionet organizuese.

Në fund, komandanti i FSK-së, shtoi: "Në këtë proces të shkollimit dhe edukimin të kadetëve të FSK-së, një rol të fuqishëm po jep në vazhdimësi Universiteti Amerikan në Kosovë, për çka me këtë rast shprehim falënderimin tonë institucional".

Ndërsa, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës (SHBA) gjeneralmajor Timoty Orr, fillimisht kadetëve ju dëshiroi suksese në detyrat e reja dhe përgjegjësi për to; Ai, me këtë rast, tha: "për më tepër se katër vite kemi punuar së bashku, në Kosovë, për ta krijuar këtë forcë të sigurisë, me çka duhet të jeni krenar të gjithë. Që nga sot, ju po bëheni oficerë udhëheqës, sepse ju e keni zgjedhur një rrugë të shenjtë dhe si do ta drejtoni sot e tutje, do të vendosni se çfarë oficeri do të bëheni. Ju keni marrë mësime të shumta se si do të bëheni lider dhe si t'i merrni vendimet e duhura në kohën e duhur, tha në fund gjeneral Orr.


Kadetët të cilët u graduan, janë: Adison Gara, Albion Ajvazi, Ardian Ramadani, Elbasan Sabedini, Festim Selimi, Fitim Kadrijaj, Kreshnik Zeneli, Lirim Bllaca, Shpëtim Dragobuzhda dhe Taulant Gashi. Kadeti më i mirë i kësaj gjenerate u shpallë Albian Ajvazi.

Në fund, ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjenerali Orr dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kadetëve u dhanë diplomat dhe mirënjohjet, ndërsa komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr, të gjithë kadetëve të diplomuar u dha nga një medaljon.

Në ceremoninë e diplomimit-gradimit merrnin pjesë edhe zëvendësministrat: Shemsi Veseli, Bejtush Gashi dhe Sllavisha Filipoviç, zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët: Zymer Halimi, Imri Ilazi, Enver Cikaqi, Gëzim Hazrolli, Nazmi Brahimaj, atasheu i SHBA-së në Kosovë Gjems Kot (James Kott), atasheu i Kosovës në SHBA gjeneralbrigade Xhavit Gashi, kryetari i komunës së Ferizajt, Agim Aliu, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të FSK-së, oficerë të lartë të FSK-së dhe të KFOR-it, familjarë të kadetëve dhe qytetarë të shumtë.

FSK-ja ngriti urën metalike mbi lumin Drini i Bardhë

Knupp Oliver, oficer i KFOR-it: FSK-ja është shumë e organizuar dhe e përgatitur profesionalisht për ngritjen e urave mobile.



Batalioni i Xhenios të FSK-së, në një afat rekord, ka ngrit urën mobile mbi lumin Drini i Bardhë, me një gjatësi prej 55 metrash që lidh të dy anët e rrugës Prishtinë-Gjakovë dhe anasjelltas.

Gjatë vizitës sonë, në Kramovik, për të përcjellë pjesëtarët e Batalionit të Xhenios së Brigadës Mbështetëse Operacionale (MBO) të FSK-së, ku po kryenin punët finale në ngritjen e urës,

biseduam me rreshter majorin Ismail Tahiri, përgjegjës për ndërtimin e urës, i cili fillimisht, na thotë : "Punët ndërtimore për ngritjen e urës i kemi filluar më datë; 17 qershor 2013, dhe me një angazhim të përgjithshëm të 26 pjesëtarëve të Batalionit të Xhenios, kemi arritur ngritjen e urës 4 ditë më herët, para afatit të paparë. Ura është e gjatë 55 metra, e gjerë 5 metra dhe mbanë pesha deri 30 tonë.

Rreshter major Tahiri, falënderon ekipin e KFOR-it, zviceran, për mbështetjen profesionale me 4 pjesëtarë, specialist të urave dhe me një automjet të rëndë (Kran), për ngritjen e peshave të rënda.

Edhe përkundër që është rasti i parë i ngritjes së një ure, në terren, për neve është me rëndësi se gjatë kryerjes së punimeve nuk kemi dëme dhe kjo është me rëndësi të madhe dhe njëherit dëshmon për shkallën e lartë të profesionalizimit të ekipit tonë të Batalionit të Xhenios të FSK-së, shton rreshter majori Ismajl Tahiri.

"Ne ndihemi krenar, që kemi mundësi me ju ndihmuar të gjithë qytetarëve të Kosovës", këtë e shprehin edhe pjesëtarët e tjerë të Batalionit të Xhenios, "sepse qëllimi ynë është ti dalim në ndihmë popullit të kësaj ane" vazhdon të na thotë, rreshter major Tahiri, për të shtuar; "ata kanë nevojë të madhe për ndihmën tonë, sepse pas reshjeve të shiut, ura e vjetër është dëmtuar shumë"

Rreshter Ismaili, nuk e fshehë gëzimin, se me të gjithë faktorët relevantë ka bashkëpunim të mirë, si me institucionet vendore-lokale dhe ato qendrore dhe me popullatën përreth.

Ismajli na thotë se ndihet shumë krenar që ka sado pak mundësi me i ndihmuar qytetarët tanë, dhe të gjithë pjesëtarët e Batalionit të Xhenios shprehin këtë krenari, sepse;"qëllimi ynë është ta ndihmojmë popullin pa marrë parasysh se ku është"

Të njëjtin mendim me rreshter majorin Ismajli, e ndanë edhe Vedat Shatri ekspert i ndërtimit të urave, i cili ka kryer së bashku me pjesëtarët e tjerë të Batalionit, trajnime të nivelit të lartë. Ai, për gazetën "Forca Jonë", na thotë: " është një privilegj edhe për mua që jam pjesëtarë i Batalionit të Xhenios, dhe që pas një trajnimi të gjatë, me KFOR-in, tani mësimet teorike dhe praktike po i zbatojmë, këtu, mbi lumin Drini i Bardhë. Siç, po e shihni edhe ju, jemi tani në fazën finale, dhe punët na kanë shkuar mirë. Më këtë besojë se do t'i ndihmojmë të gjithë qytetarët tanë".

Ndërsa, komandanti i Kampit, kapiten Islam Haliti, na thotë se: "krejt puna është realizuar në tri faza; në fazën e parë kemi bërë planifikimin dhe trajnimin, në fazën e dytë; bartjen e materialeve dhe në fazën e tretë; kemi realizuar montimin e urës. Për ndërtimin e urës, gjithsej, kemi kryer mbi 2700 orë pune".

Batalioni i Xhenios përgëzime për punën e mirë, në ngritjen e urës, kanë marrë nga Ministri dhe Komandanti i FSK-së, komandanti i MBO-së, nga ministria e Infrastrukturës dhe nga qytetarët e kësaj ane.


Ky është vetëm fillimi i një vepre të madhe dhe humane që FSK-ja ju ka dalë në ndihmë qytetarëve të saj.



Oficeri i KFOR-it, OF2 Knupp Oliver JLSG HQ KFOR, specialist i ndërtimit të urave, shprehet i lumtur që po bashkëpunon me Batalionin e Xhenios të FSK-së, për të shtuar se:" bashkëpunimi me pjesëtarët e FSK-së është shumë i mirë, shumë më i mirë se që e kam menduar, këta janë shumë të organizuar dhe të përgatitur profesionalisht për ngritjen e urave mobile, dhe të cilët, në një kohë shumë të shkurtër, kanë arritur ta montojnë urën mbi lumin Drini i Bardhë, për të shpreh bindjen se FSK-ja është e përgatitur profesionalisht për ngritjen e veprave të rëndësishme.

Edhe pse në Kosovë, jam qe 8 muaj, jam i befasuar për të mirë, sepse këtu njerëzit janë shumë të mirë, janë human dhe mysafirët i presin me zemër hapur, ndërsa kjo është një ndjenjë e mirë kur i sheh pjesëtarët e FSK-së, sa profesionalisht bëjnë ngritjen e urës, kjo vlen sepse gjatë dhjetë ditëve, këtu nuk ka pasur as më të voglin problem" shtoi oficeri Zviceran Knupp Oliver.





FORCA JONË

Ministri, komandanti, ambasadorët dhe atashetë ushtarakë përcollën operacionin e deminimit të FSK-së, në Luzhnicë të Duhlës

Impresionohen me profesionalizmin e deminuesve të FSK-së

Ministria e FSK-së, ka organizuar sot, një vizitë pune, për ambasadorët dhe atashetë ushtarak të akredituar në Kosovë, ku nga afër kanë përcjellë njësinë e deminimit të FSK-së, në lokacionin Luzhnicë - Duhël. Në këtë lokacion Togu i III i Kompanisë së deminimit të FSK-së, që nga viti i kaluar është duke punuar për pastrimin e terrenit nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera.

Në fillim vizitorët panë dhe dëgjuan një prezentim nga oficerët e kompanisë së deminimit, me të dhëna statistikore të shumëllojshme nga fusha e deminimit, duke filluar nga viti 1999 e deri më sot: Në vitin 1999 janë regjistruar 4500 fusha të rrezikshme dhe fatkeqësisht, nga këto mbi 56.137 metra katror si dhe ka shkatërruar 55 bomba kasetore.

Ministri i FSK-së Agim Çeku, falënderoi ambasadorët dhe shtetet e tyre që kanë ndihmuar në ngritjen dhe profesionalizmin e deminierve të FSK-së dhe për donacionet në aparatura dhe teknikë. Ministri Çeku u shpreh se jemi këtu, që të dëshmojmë se ndihma e tyre ka shkuar në vendin e duhur. Duke theksuar nivelin e lartë të profesionalizmit ai vlerësoi se kjo njësi është e gatshme të jap kontributin e vete në misione humanitare të deminimit edhe jashtë vendit.

Në falën e tij Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati përgëzoi deminerët e pranishëm dhe të gjithë deminerët FSK-së në





mina kanë humbur jetën 115 veta, dhe 454 qytetarë kanë mbetur të lënduar. Shumica e këtyre rasteve ka ndodhur gjatë perisudhës së viteve; 1999-2000, ndërsa në vitin 2012 ka pasur katër incidente, ku, si pasojë e shpërthimit të mejeteve eksploduese ka vdekur një (1) person dhe 6 veta kanë pësuar lëndime. Janë pastruar mbi 102 milion e 772,788 metra katror, të terreneve dhe fushëbetejave në Kosovë. Në Kosovë që nga pas lufta, janë identifikuar 1300 caqe të godituara nga NATO, 620 fusha të minuara, 2600 mjete eksploduese plasëse të raportuara, 4520 zona të rezikshme, ndërsa në vitin 2013, mbeten edhe 54 zona të rrezikshme si dhe 44 zona të rrezikshme të dyshuara.

Në vitin 2013 nuk është raportuar ndonjë rast i vetëm që ka pësuar nga mjetet e pa shpërthyera. Togut i III-të i Kompanisë së dominimit të FSK-së, në lokacionin e Duhël -Lluzhnicë, që nga viti i kaluar (2012), ka pastruar teren anekënd Kosovës. Ai theksoi se njësitë e deminimit të FSK-së do të vazhdojnë punën deri sa Kosova të jetë tërësisht e sigurt.

Nga radha e vizitorëve ndërkombëtarë foli zëvendës ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë zoti Gjoe Preston (Joe Preston). Ai u shpreh se është i impresionuar me nivelin e kompanisë së demimimit me punën e rëndësishme që po bëjnë për eliminimin e rrezikut për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Ai po ashtu shprehu kënaqësinë që deminieret kanë mjete gjithnjë e më të mira.

Me këtë rast ministri Çeku, në prani të vizitorëve dhe gazetarëve demonstroi demolimin e një mjeti të pa shpërthyer.

Në vizitën e ambasadorëve dhe atasheve ushtarak deminireve në lokacionin Duhël- Luzhnicë, morën pjesë edhe zëvendësministrat e FSK-së, gjeneralë të FSK-së, pjesëtarë të Ekipit Këshillues të NATO-s, oficer të lartë të Divizionit.

Më datën 11. 07. 2013, në ambientet e Ministrisë së FSK-së, është mbajtur takimi i rregullltë me atashetë ushtarak të akredituar në Kosovë.

Gjatë këtij takimi të pranishmit janë njoftuar nga nënkolonel Hasan Hoxha, ushtrues i detyrës së drejtorit të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, me objektivat e MFSK-së dhe FSK-së, kampanjën e rekrutimit të minoriteteve si dhe është bërë një prezantim për RSSS nga gjeneralbrigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione të MFSK-së.

Pas këtij takimi atashetë ushtarak kanë vizituar lokacionin e Luzhnicës në Duhël, ku është bërë një demonstrim nga ekipet deminuese të FSK-së.



FSK-ja kthehet me medalje nga marshimi ushtarak në Holandë

Ky është viti i tretë rresht që Kontingjenti i FSK-së, kthehet me sukses të plotë, nga marshimi tradicional i mbajtur në Holandë, e ku morën pjesë ushtritë e 53 shteteve anëtare të NATO-s dhe të shteteve të tjera të botës.

Marshi ushtarak i Njimengen-it daton që nga viti 1909 dhe është ngjarja më e madhe e këtij lloji në botë. Këtë viti, Marshimi tradicional u mbajt, nga data 14-21 korrik 2013, ku sipas rregullave të marshit, çdo ditë ekipet kanë marshuar nga 40 kilometra dhe të gjithë pjesëmarrësit e ekipit është dashtë të hyjnë në cak, në kohën paraparë sipas organizatorit, me kohë.

Kontingjenti i FSK-së, këtë vit është përfaqësuar me 30 pjesëtarë, në mesin e tyre morën pjesë edhe 4 pjesëtare të FSK-së, të udhëhequr nga togere Fatbardha Osaj.

Edhe këtë vit, kontingjenti i FSK-së e arriti suksesin e viteve të kaluara, ku komplet, të gjithë pjesëtarët e Kontingjentit kalojnë shtegun prej 160 km.

Për të përcjellë finalen e marshimit, në Nijmegen, kishin marrë pjesë; Ambasadori i Republikës se Kosovës në Mbretërinë e Holandës, z. Nexhmi Rexhepi dhe zëvendëskomandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, të cilët kanë urua pjesëtarët e Kontingjentit, për suksesin e tyre, dhe në shenj mirënjohje u japin medalje të gjithë pjesëtarëve të kontingjentit të FSK-së, për gara individuale, si dhe Medalje si ekip.

Ndërsa, togere Fatbardha Osaj, udhëheqëse e kontingjentit të FSK-së, na thotë: "secili ekip është dashtë ta kryejë marshimin në kohën e caktuar si ekip, d.m.th. të gjithë pjesëtarët e ekipit është dashur që më kohë të arrijnë në cak. Kontingjenti i FSK-së është shpërblyer me medalje si ekipi më i mire, si dhe me medalje individuale. Sipas statistikave të organizatorit, ekipi i FSK-së, edhe dy vitet e para ka arritur suksesin më të madh si ekip në historinë e saj.



Për arritjen e këtij suksesi, togere Osaj, na thotë: Të gjithë pjesëtarët e FSK-së kanë arritur të përfundojnë këtë marshim me sukses, të gjithë kanë arritur në cak, dhe për këtë kanë marr medalje dhe certifikata individuale, por edhe si ekip është nderuar me medalje. Motivi disiplina, entuziazmi dhe përgatitja fizike e pjesëtarëve të FSK-së ka qenë në nivel të lartë, kjo ka bërë që jemi dalluar nga shumë Kontingjente të ushtrive të shteteve tjera. Nga 53 kontingjente që kanë qenë pjesëmarrëse jemi një nga pak kontingjentet të cilat kanë arritur të përfundoj marshimin të gjithë pjesëtaret me sukses" shtoi në fund udhëheqja e Kontingjentit Toger Fatbardha OSAJ.



Oficerë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vizitë trejavëshe në FSK

23 oficerë-instruktorë dhe kadetë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës po qëndrojnë për një vizitë zyrtare në FSK, që nga data: 25 korrik- 16 gusht. Qëllimi i vizitës është thellimi i bashkëpunimit me homologët, si dhe ngritjen e nivelit të njohurve të përgjithshme dhe njohurive profesionale.

Oficerët amerikanë, gjatë qëndrimit në FSK, do t'i vizitojë të gjitha njësitet e saj, ku do të mbajnë ligjërata të ndryshme për pjesëtarët e FSK-së. Oficerët amerikanë, gjithashtu, do t'i vizitojnë edhe vendet historike në Kosovë, ku do të njoftohen me të kaluarën dhe historinë e Kosovës.

FSK-ja dhuroi mbi 300 doza gjak

Në ambientet e ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), edhe këtë vit, ka filluar aksioni humanitar për dhurimin e gjakut, në organizim të Departamentit të Mjekësisë së FSK-së, Departamentit të BCU-së dhe në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK).

Aksioni humanitar i dhurimit të gjakut ka filluar më 1 korrik në Ministrinë e FSK-së dhe është mbajtur në të gjitha njësitet dhe kazermat e FSK-së. Aksionin e kanë kryer infermieret e QKTGJK në bashkëpunim me infermierët e Batalionit të Mjekësisë së FSK-së.

FSK-ja ka një traditë të organizimit dhe të dhurimit humanitar të gjakut, dhe ky është viti i pestë që FSK-ja, po dhuron gjak. Pjesëtarët e FSK-së jo vetëm gjatë organizimit të aksioneve të rregullta, por ata po dhurojnë gjak edhe jashtë këtyre organizimeve, dhe janë gjithmonë të gatshëm për dhurimin e gjakut edhe në të ardhmen, çdo herë, për nevojat e pacientëve që kanë nevojë për gjak.

Sipas stafit udhëheqës të QKTGJ-së, pjesëtarët e FSK-së janë donator të rregullt të dhurimit të gjakut dhe se çdoherë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni. Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut ka përfunduar më 25 korrik. Këtë vit, FSK-ja ka dhuruar mbi 300 doza gjak, e që do të jenë në shërbim të gjithë atyre që kanë nevojë për gjak.



Certifikohen nënoficerët rezervë të FSK-së

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve të Kursit të nënoficerëve të komponentës rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerata 01. 2013. Në ceremoninë e certifikimit të nënoficerëve, morën pjesë; komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, nënkolonel Marko Paskualloni, përfaqësuesi i ekipit mentorues, oficerë tjerë të FSK-së dhe familjarë të pjesëtarëve të certifikuar.

Me rastin e certifikimit të kadetëve të komponentit rezervë, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneralbrigade Enver Cikaqi falënderoj kadetët për angazhimin e tyre maksimal, familjarët për mbështetjen e kadetëve në kurs dhe instruktorët për përkushtim në realizim të kursit. Më tej, gjeneral Cikaqi ka shtuar: "ndihem krenar me punën e palodhshme që keni bërë gjatë kursit të realizuar për 8 javë në KDS, ndërsa rezultatet tuaja na bëjnë të ndihemi mirë të gjithëve, sepse ju keni treguar përkushtim, disiplinë, por edhe nivel të lartë të rezultateve në teste".

Ndërsa, në emër të ekipi mentorues të NATO-s, një fjalë rasti e mbajti, nënkoloneli Marko Paskulloni i cili shprehu falënderimet e tij, për rastin e dhënë që të dal para nënoficerëve në ditën e certifikimit. Ai i përgëzoi kadetët për angazhimet e tyre gjatë trajnimit, si dhe ju dëshiroj fat dhe suksese në karrierën e tyre.



Kursin tetë javor e kanë kryer 21 pjesëtarë të FSK-së, nga grada tetar deri te grada rreshter major, i cili kurs është realizuar dhe mbajtur nga instruktorë të KDS-së. Gjatë mbajtjes së kursit në hapësirat e kazermës "SKËNDERBEU" në Ferizaj, është realizuar edhe një ushtrim fushor dy-ditor, si pjesë e programit të kursit të cilin e kanë ndjekur të gjithë nënoficerët aktiv dhe rezervë e që është bërë kombinimi i pjesës teorike me pjesën praktike.

Në fund, janë shpallë kadetët më të mirë, të cilët janë nderuar me mirënjohje dhe çmime.

Rreshter Behar Gashi u nderuar me mirënjohje për arritje akademike,

rreshtermajor Nezir Kadrija u nderuar me mirënjohje për standarde të larta në udhëheqje,

Rreshteri Fitim Bejtullahu, është nderuar me mirënjohje për disiplinë, ndërsa tetari Shpëtim Nasufi, nderohet me mirënjohje për arritje të standardit në fitnes fizik dhe kapter Abedin Tahiri, nderohet me mirënjohje, "çmimi i Komandantit".

Ndërsa, instruktori më i dalluar shpallet rreshteri Ekrem Tahiri.

Ky kurs realizohet nga viti 2009, i cili vazhdimisht është duke u profesionalizuar, ndërsa është gjenerata e parë e komponentës rezervë që përfundon këtë kurs.



Rreshter Majori i FSK-së Genc Metaj, diplomoi në Akademinë Ushtarake në SHBA

Rreshter Major Genc Metaj, oficer i FSK-së, ka kryer me sukses studimet ushtarake në Akademinë e Rreshter Majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht në Bazën Fort Bliss, në El Paso, në Teksas,(për 12 muaj).

Akademia e Rreshter Majorëve në SHBA, është institucioni më i avancuar, përkatësisht niveli më i lartë i shkollimit për edukimin e nënoficerëve në Akademinë e Rreshter Majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë gjeneratë, kanë qenë mbi 650 nënoficerë, në mesin e tyre edhe 41 oficerë, përfaqësues të 32 shteteve të botës.

Rreshter Majori Genc Metaj, është pjesëtari i parë nga Republika e Kosovës-FSK-ja, që ka kryer shkollim ushtarak në këtë Akademi, që është me interes shumë të rëndësishëm, jo vetëm për Rreshter Majorin Metaj, por, edhe për vetë FSK-në.

Akademia e Rreshter Majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në përgjithësi, është një Akademi që përgatit Rreshter-Majorë, për temat: për Principet e lidershipit, për Udhëheqjen e trupës së nënoficerëve, për kështillimin e nivelit të lartë të oficerëve lidhur me funksionimin e trupës së nënoficerëve, për ekzekutimin e operacioneve të përbashkëta tokësore, duke përfshirë të gjitha Degët e Ushtrisë Amerikane si dhe operacionet ndërkombëtare në bashkëpunim edhe me agjencitë e ndryshme.

Gjatë qëndrimit në El Paso, Rreshter Major Metaj, për merita të jashtëzakonshme dhe për arritje të përgjithshme është nderuar me çmimin "Qytetar Nderi i El Pasos", nga Prefekti John Cook i këtij qyteti.

Gjithashtu, Genc Metaj krahas Akademisë Ushtarake ka kryer me sukses edhe shkollimin Shkallën "Master" në Shkencat e Lidershipit në Universitetin e Teksasit, në El Paso.

Për të arriturat e përgjithshme në Akademinë Ushtarake në SHBA, Rreshter Major, Genc Metaj, është dekoruar edhe nga Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me medaljen "E Ardhmja Fillon Këtu".

Shkollimi i Rreshter Majorit Metaj, në SHBA, ka qenë 12 muaj dhe është mbështetur nga Zyra për Mbrojtje dhe Bashkëpunim pranë Ambasadës së SHBA-së. M e rastin e organizimit të diplomimit në Akademinë e Rreshter Majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka marrë pjesë; atasheu Ushtarak i Republikës së Kosovës, në SHBA gjeneralbrigade Xhavit Gashi dhe Rreshter Major Rachel Fails, nga Garda Kombëtare e Ajovës, të cilët njëherit e kanë përgëzuar Genc Metaj, për të arriturat e tij të përgjithshme.

FSK-ja shënoi Ditën e Pavarësisë së SHBA-ve

Kadetët dhe instruktorë të FSK-së, për nder të 4 korrikut, Ditës së Pavarësisë së SHBA-ve, së bashku me përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-ve, në Prishtinë e ku mori pjesë edhe një këshilltar i Britanisë së Madhe, morën pjesë në vrapimin simbolik, prej 12 kilometrave, në Parkun "Gërmia".

Qëllimi i vrapimit ishte të arrihej te Kullat e radiove të Kombeve të Bashkuara, në majë të parkut Gërmia. Kadetët e FSK-së thanë se ishte nder për ta, që ta arrinin një qëllim kaq të vështirë pranë kolegëve të tyre të SHBA-ve, në Ditën e Pavarësisë.s



FORCA JONË

□□□ Viti II □ Nr. 16 □Shtator 2013 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Ministri i FSK-së Agim Çeku vizitoi Mbretërinë e Bashkuar



Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar Andru Morrison (Andrew Murrison), më 6 gush 2013, qëndroi për një vizitë treditore në Mbretërinë e Bashkuar. Ministri Çeku ishte i shoqëruar edhe nga komandanti i Komandës së Forcës Tokësore të FSK-së, gjeneral-major Rrahman Rama.

Gjatë vizitës në Mbretërinë e Bashkuar, ministri Çeku u prit nga ministri i Mbrojtjes, Andru Morrison dhe nga shefi i Shtabit të Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, gjenerali Nikolas Haugton (Nicholas Haughton).

Gjatë qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar, ministri Çeku dhe gjeneral Rama morën pjesë edhe në ceremoninë e diplomimit të kadetëve të organizuar nga Akademia Ushtarake Mbretërore, Sandhurst, ku në mesin e të diplomuarve ishin edhe dy kadete të FSK-së. Pas ceremonisë së diplomimit të kadetëve, ministri i FSK-së Agim Çeku dhe gjeneralmajor Rrahman Rama, zhvilluan takime të rëndësishme me drejtuesit e Akademisë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst" si dhe me personalitete dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve të ndryshme ushtarake.

Ministri i FSK-së, ka falënderua ministrin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, Andru Morrison dhe shefin e Shtabit të Mbrojtjes, gjeneralin Nikolas Haugton, për ndihmën e gjithanshme, që Mbretëria e Bashkuar po i jep në vazhdimësi Forcës së Sigurisë të Kosovës. Me këtë rast, ministri Çeku, informoi mikpritësit me zhvillimet në FSK; me konfirmimin e NATO-s për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale si dhe me ecurinë e procesit të Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë. Po ashtu të dy palët biseduan për realizimin e dinamikës së planit të bashkëpunimit sipas Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të dy ministrive përkatëse

Vizita e Ministrit Agim Çeku në Mbretërinë e Bashkuar është në vazhdën e thellimit dhe bashkëpunimit të mirë dhe intensiv që është duke u zhvilluar në mes të dy shteteve dhe dy ministrive përkatëse.

Certifikohen 30 rekrutë të FSK-së nga radhët e komuniteteve



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), në Ferizaj, më 23 gusht 2013, u mbajt ceremonia e certifikimit të rekrutëve të gjeneratës së parë, për këtë vit, të kursit bazik, për rekrutët aktivë, nga radhët e komuniteteve.

Kursi bazik ka zgjatë 9 javë dhe është realizuar në tri module me 20 lëndë mësimore, nga instruktorët e Qendrës së Stërvitjes Bazike të KDS-së.

Në mesin e rekrutëve, 26 pjesëtarë janë nga komuniteti serb, dy të atij boshnjak, një turk dhe një ashkali.

Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë: ministri i FSK-së Agim Çeku, zëvendësministrat: Muhamet Latifi, Bejtush Gashi dhe Sllavisha Filipoviq, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendës ambasadorja e SHBA-ve, zonja Kelly Degnan, atasheu ushtarak i SHBA-ve, koloneli James Kott, ambasadori i Britanisë së Madhe Ian Kliff, gjenerali i KFOR-it, gjeneral brigade Salvatore Carta, atashe ushtarak të kredituar në Kosovë, gjeneralë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, të NAT-it, familjarë dhe të afërm të pjesëtarëve të rekrutëve, etj. *(Vazhdon në faqen, 6)*

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti zëvendëskomandantin e KFOR-it, gjeneralbrigade Bojan Pograjc



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti në një takim në ministri, zëvendëskomandantin e KFOR-it, gjeneral brigade Bojan Pograjc, të cilin fillimisht e njoftoi për zhvillimet e FSK-së, për planet dhe për aktivitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si edhe për bashkëpunimin intensiv me KFOR-in dhe ushtritë partnere të vendeve të rajonit.

Gjenerali Kadri Kastrati, gjithashtu, e njoftoi gjeneralin Pograjac edhe me planet, me synimet dhe me hapat të cilët është duke i ndjekur FSK-ja, për t'u zhvilluar dhe për të qenë e denjë për partneritet për paqe dhe integrime euro-atlantike në të ardhmen. Ai e njoftoi edhe me projektet e përgjithshme humanitare të cilat i ka realizuar FSK-ja, gjatë këtyre ditëve, në të mirë të komunitetit në disa rajone të Kosovës, gjithashtu projektet humanitare për të kthyerit, etj.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadrti Kastrati, gjithashtu, e njoftoj gjeneralin Bojan Pograjc me përfshirjen e minoriteteve në FSK, pastaj të femrave si edhe mbi zhvillimin profesional të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së, në mënyrë që ta tregojmë konkretisht përkushtimin e FSK-së, për të qenë Forcë jashtëzakonisht serioze dhe e pranueshme për partnerët tanë.

Gjeneral Kastrati tha se FSK-ja është duke u zhvilluar në bazë të kritereve dhe standardeve të NATO-s, si dhe duke shfrytëzuar praktikat më të mira të cilat i kanë ndjekur edhe vendet e rajonit.

Nga ana e tij, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Bojan Pograjc u shpreh se deklarimi nga NATO-ja i Kapaciteteve të Plota Operacionale për FSK-në, është një sukses për FSK-në dhe për lidershipin e saj.

Gjeneral Pograjc, me pas i shoqëruar nga gjeneral Imri Ilazi, drejtor i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve në MFSK dhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i Komandës së Forcës Tokësore, vizituan Qendrën për Studime Universitare të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së.

Në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, gjeneralin Pograjc, e njoftuan me programin studimor dhe me aktivitetet e përgjithshme të Qendrës, institucion ushtarak ky, i cili arsimon dhe përgatit oficerët e FSK-së.



Gjenerallejtënant Kadri Kastrati zhvilloi një takim me gjeneralmajorin e NATO-s, Jozef Blotz

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, priti në Ministrinë e FSK-së, gjeneralmajorin Jozef Blotz, drejtor i Stafit Ushtarak Ndërkombëtar të Operacioneve (International Military Staff Operations Director (IMS DIR) i NATO-s. Ai shoqërohej nga zëvendësshefi i Shtabit të KFOR-it, gjeneral brigade Salvatore Carta, kolonel Jurgen Stahle (SHAPE CCCOM COG BAL) dhe nënkolonel Benoit Tailliandier, oficer i stafit të Operacioneve Ushtarake Ndërkombëtare.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati e falënderoi drejtorin e Stafit Ushtarak të Operacioneve të NATO-s, gjeneralin Blotz, për ndihmën e përgjithshme që kanë dhënë në vazhdimësi për FSK-në, si dhe e ka njoftuar me të arriturat e përgjithshme të FSK-së; me strukturën, organizimin, përqindjen e komuniteteve, barazinë gjinore, operacionet e deminimit dhe me projektet humanitare që po i kryen FSK-ja. Gjithashtu, komandanti i FSK-së e njoftoi gjeneralin Blotz, edhe për Rishikimin e Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe bashkërendimet që po i kryejnë me Ekipin Këshillues të NATO-s(NAT), e informoi edhe për procesin e trajnimeve, bashkëpunimin rajonal dhe bashkëpunimin profesional që ka me Gardën Kombëtare të Ajovës. Në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati ka kërkuar vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë që ka me KFOR-in dhe NATO-n.

Po ashtu ai shprehu interesimin për shkollimin e pjesëtarëve të FSK-së, në shkolla të NATO-s, si dhe për pjesëmarrjen e FSK-së në operacione paqësore ndërkombëtare.

Ndërsa, drejtori i Stafit Ushtarak të Operacioneve, gjeneralmajori Jozef Blotz e falënderoi komandantin e FSK-së, për pritjen dhe njëherësh e përgëzoi për arritjet e përgjithshme të FSK-së, sidomos për plotësimin e kapaciteteve operacionale, të arriturat e njësive profesionale, pjesëmarrjen e përgjithshme të pjesëtarëve të komuniteteve në kuadër të FSK-së, si dhe për bashkëpunimin e mirë që ka me KFOR-in dhe me ekipin e NAT-it.

Në fund, gjenerali Blotz, tha se Kosova dhe misioni i KFOR-it në Kosovë është i një rëndësie të veçantë dhe mbështetja e NATO-s për FSK-në do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Në takim ishte i pranishëm edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli.

Fjala e ministrit të FSK-së, Agim Çeku, mbajtur në Konferencën e 6-të Rajonale të Kampit Euro-Atlantik "REACT" 2013, në Mal të Zi

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, në Konferencën e 6-të Rajonale të Kampit Euro-Atlantik "REACT" 2013, që po mbahet në Plavë, Mal të Zi, para pjesëmarrësve të kësaj konference, mbajti ligjëratën, me temë "Republika e Kosovës në Marrëdhëniet Ndërkombëtare Bashkëkohore" Në këtë konferencë po marrin pjesë personalitetet më të larta politike, ushtarake, OJQ-të, përfaqësues të medieve, studentë të universiteteve të ndryshme të botës, nga shumë shtete,etj.

"Kosova ka qenë në fokus të diplomacisë ndërkombëtare dhe evropiane, gjatë periudhës kur diplomacia ndërkombëtare dhe evropiane ishte në zhvillim të jashtëzakonshëm. Kosova ka qenë një shembull i suksesshëm, shembulli i parë i konceptit të ri: konceptit të intervenimit humanitar për t'i parandaluar krimet ndaj civilëve.

Kosova ka qenë shembulli i parë praktik dhe ka ndihmuar në krijimin e teorisë së re, teori e paraqitur fillimisht, si doktrina e Blerit, (kryeministër i Britanisë së Madhe), në fjalimin e tij, mbajtur në Çikago -ideja që nganjëherë komuniteti ndërkombëtarë ka pas të drejtë dhe madje obligim për t'u përfshirë në situata të tilla, në baza të moralit", tha në fillim ministri i FSK-së, Agim Ceku.

"Së dyti, Unë mendoj që Kosova duhet të shihet si kontekst i luftës së re të ftohtë. Ne jemi viktima e luftës së re të ftohtë: beteja për ndikimin në mes të SHBA-ve e cila përpiqet të eksporton demokracinë në botë dhe ajo e Rusisë së Putinit e cila po mundohej ta rithemelon identitetin dhe ndikimin rus.

E treta, Kosova ishte testi i administratës ndërkombëtare. Që nga viti 1999, vendi im ishte i kontrolluar nga diplomatët dhe ekspertët ndërkombëtarë. Kosova është produkt i asaj së çfarë ndodh, kur bota i dërgon ekspertët e saj, për ta ndërtuar një shtet të ri. Unë mendoj që Kosova është një shembull i jashtëzakonshëm i zhvillimit institucional dhe zhvillimit të kapaciteteve në një periudhë të shkurtër kohore.

E katërta, Kosovën duhet ta konsiderojmë si çështje të BE-së. Të gjitha shtetet në këtë regjion kanë perspektivë të BE-së; ky është mesazhi e deklaratës së Thessalonikut. Kosova është çartë pjesë e fqinjëve të afërta të shteteve të BE-së. Kosova është çështje, ku BE më të vërtet mund të kontribuojë, dhe vendi ku dëshiron të ndihmojë. Por, Kosova ka vuajtur nga dështimi i BE-së, për t'i tejkaluar ndarjet e saja interne dhe bërjen e politikave të qarta dhe të fuqishme. BE-ja e ka marrë përgjegjësinë për sundimin e ligjit në veri të Kosovës, por, ende nuk ka pasur pushtet apo fuqi për ta arritur. Kosova është një shembull i potencialit të madh të BE-së dhe unë jam krenar për marrëdhënien me BE-në.

Konteksti i pestë, është diplomacia regjionale. Këtë vit, ne e kemi parë një zhvillim të pashembullt diplomatik: marrëveshjen në mes të



Republikës së Kosovës dhe të Serbisë. Kjo marrëveshje ka qenë jo vetëm një hap i rëndësishëm, por edhe një mënyrë e re e lidhjes së raporteve. Unë shpresoj që kjo shënon një fund definitiv të asaj ere të vjetër dhe fillimin e një ere të re. Unë e kam provuar erën e vjetërdhuna, vrasjet, djegiet e shtëpivedhe jam personalisht i përkushtuar ndaj erës së re. Por tanimë ka pasur dështime për t'ju përmbajtur pjesëve të marrëveshjes dhe prapë dalin pyetjet. A i ka thyer dialogu Kosovë-Serbi, atë praktikë të dikurshme? A e ka treguar ajo që pushteti i BE-së, mund të inkurajoj dy shtete të bëjnë progres të ri? Apo ishte një bisedë e vjetër, pa ndikime konkrete, e cila i kontribuon imazhit të BE-së, por nuk e ndryshon realitetin e Kosovës dhe Serbisë.

Neve na duhet një qasje e re, për marrëdhëniet në Ballkan. Ne i kemi zyrtarizuar kufijtë. Shtetet janë tani më të sigurta në identitetin e tyre dhe kufijtë e tyre. Shtetet janë më të përgatitur të bisedojnë në mes vete. Në Ministrinë time, jemi duke i zhvilluar aktivitetet e përbashkëta me shtetet fqinje, përfshirë këtu edhe dërgimin e trupave në mbështetje të Shqipërisë gjatë fatkeqësisë së fundit natyrore. Ne jemi duke shkëmbyer përvojat dhe kapacitetet me shtete e rajonit.

Në Kosovë kemi krijuar institucione të zakonta të shtetit, ku zhvillojmë marrëdhënie normale si çdo shtet tjetër. Ka dy faktorë në thelb, të këtij procesi: së pari, është dëshira e popullit të Kosovës dhe e komuniteteve etnike-për normalizimin e jetës. Të gjithë ne dëshirojmë që fëmijët tanë të kenë një jetë më të qetë dhe me më shumë prosperitet në jetë, sesa çfarë ne e kemi pasur. Së dyti, marrëdhëniet tona të afërta me komunitetin ndërkombëtar, standardët e të cilëve ne i mbështesim.

Ne kemi kaluar në fazë të re: fazën e partneriteteve në regjion. Faza tjetër dhe më e rëndësishmja do të jetë në komunitetin regjional. Kosova tashmë filloi të luaj rolin e saj në konferenca regjionale, etj. Tani ne duhet të mendojmë për aktivitetin ekonomik të komunitetit, aktivitetin diplomatik, aktivitetin e sigurisë. Së pari vjen stabiliteti në regjion, tani bashkëpunim në regjion dhe atëherë regjioni vepron përtej kufijve të sajë, në mënyrë pozitive. Kjo do ta kompletojë udhëtimin e Kosovës dhe për regjionin tonë. Dhe do ta vendosë vendin tonë në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare jo si eksperiment, jo si punë në zhvillim, por si një sukses i qartë, sukses final. Fjalimi i ministrit të FSK-së, u përcoll me interesim të madh nga të gjithë të pranishmit, në Konferencën e 6-të Rajonale të Kampit Euro-Atlantik "REACT" 2013, mbajtur në qytetin e Plavës në Mal të Zi.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Oficerë të mjekësisë nga EUKOM-i qëndruan për një vizitë pune në FSK

Një delegacion i ekspertëve mjekësorë të EUKOM-it, i udhëhequr nga nënkolonel Mark Rogers, shef për Plane dhe Operacione Mjekësore i USAFE/AFRICA dhe Victoria Lynch, kapiten, specialist i Evropës për shëndetësi ndërkombëtare, qëndroi për një vizitë zyrtare në Ministrinë e FSK-së dhe në FSK.

Qëllimi i vizitës së ekspertëve mjekësorë të EUCOM-it, është vazhdimi dhe thellimi i bashkëpunimit në mes FSK-së dhe EUCOM-it, në drejtim të zhvillimit të mjekësisë së FSK-së. Fillimisht, delegacioni i EUCOM-it, u pritë në Ministrinë e Forcës së Sigurisë, nga drejtori i Departamentit të Mjekësisë në MFSK, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, i cili më pastaj e shoqëroi delegacionin, gjatë vizitës së punuese në FSK.



Delegacionin e ekspertëve të EUCOM-it , e priti edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili falënderoi ekipin e EUKOM-it, për ndihmën e pakursyer që po japin, në të gjitha drejtimet e FSK-së, si dhe në ngritjen profesionale të mjekësisë së FSK-së.

Ekipi i mjekësor i EUCOM-it, vizitoi edhe Kompaninë e Mjekësisë së FSK-së dhe Komandën e Forcës Tokësore.

Në Kompaninë e Mjekësisë u pritën nga komandanti i saj, nënkolonel dr. Hamide Osaj dhe major dr. Genc Shala, zëvendës komandant i Komandës së Mjekësisë. Me këtë rast, nënkolonel Osaj e njoftoi delegacionin e ekspertëve të EUCOM-it, për punën, për stafin profesional dhe projektin e zhvillimit të mjekësisë së FSK-së, për të ardhmen.

Ndërsa, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, e njoftoi delegacionin e EUCOM-it, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për kapacitetet e Kompanisë së Mjekësisë, për specializimin e personelit mjekësor, për përvojën e tyre të gjatë, në lëmin mjekësor dhe atë ushtarak: "Jemi duke punuar që t'i rrisim këto kapacitete dhe shpresojmë shumë se me hapjen e Poliklinikës, do të kemi mundësi, që t`u dalim në ndihmë mjekësore edhe shumë qytetarëve të Kosovës; veteranëve , personelit të lartë apo edhe personelit ndërkombëtar që është në Kosovë" tha në fjalën e tij gjeneral Hazrolli. Në fund gjeneral brigade, Gëzim Hazrolli, kërkoi vazhdimin e bashkëpunimit dhe bartjen e përvojave të dyanshme, për stafin e mjekësisë dhe anasjelltas.

Ekspertët e EUCOM-it, ishin të kënaqur me vizitën dhe me zhvillimet e FSK-së, e veçmas me të arriturat e Kompanisë së Mjekësisë. Ata shprehën gatishmërinë e tyre për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen me stafin e mjekësisë të FSK-së.

Delegacioni i ekspertëve mjekësor të EUCOM-it, vazhdoi vizitën e tij të punës edhe në Brigadën e Reagimit të Shpejtë të FSK-së, në Istog, ku u pritë nga komandanti i saj, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, i cili i njoftoi, gjerësisht, me personelin mjekësor që shërben në Brigadën e Reagimit të Shpejtë.

Kontigjenti i BRSH-së me sukses ka përfunduar trajnimin "Vëzhgim-Zbulim" në Turqi

Kontigjenti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) të FSK-së, me 33 pjesëtarë, pas një trajnimi dy javësh, të mbajtur në shkollën e Kombsorisë "Ataturk" në Republikën e Turqisë, nga data 10-24 gusht 2013, ka përfunduar me sukses trajnimin "Vëzhgim dhe Zbulim".

Kontigjenti i BRSH-së, nga Kazerma "Adem Jashari" e KFT-së, ka bërë dislokimin për në Shtetin e Turqisë, me datën: 10 gusht 2013, ku në përcjellje, kanë marrë pjesë; zëvendëskomandnati i KFT-së, gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci dhe shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri .

Me rastin, e nisjes së kontingjenitt, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneralbrigade Gëzim Hazrolli, në emër të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe në emër të komandantit të KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, ka kërkuar nga ushtarët që ta përfaqësojnë denjësisht FSK-në, dhe që njohuritë e fituara t'i bartin me sukses në njësitet e tyre. "Unë jam shumë i bindur se ju do ta kryeni këtë trajnim ashtu siç është më së miri dhe do të ktheheni me rezultate të shkëlqyeshme. Njohuritë e fituara në Turqi , padyshim se do t'i bartni me sukses tek njësitë tuaja. Ky trajnim ka rëndësi të shumëfishtë për ju dhe për FSK-në, kur dihet se do të mbahet në Qendrën e nivelit të lartë profesional të Armatës së Turqisë, dhe për këtë, kërkoj nga ju përkushtim, disiplinë dhe profesionalizëm, edhe pse jam i bindur se këto nuk ju munguar asnjëherë pjesëtarëve të FSK-së".

Trajnimi i kontingjentit të BRSH-së, është zhvilluar në dy drejtime, atë të mësimit teorik dhe praktik. Mësimet teorike janë mbajtur në salla të mësimit, ku kushtet kanë qenë shumë të mira; të pajisura me kompjuter, projektor dhe janë zhvilluar me sllajde, na tregon, komandanti i Kontingjenit, toger Mexhid Shabani.



Ndërsa, mësimet praktike janë zhvilluar në terren të hapur, në hapsirat e shkollës të cillat kanë qenë adekuate për zhvilimin e trajnimit, gjatë gjithë kohës, na kanë mbështetur me të gjitha mjetet që kanë qenë të nevojshme për zhvillimin e trajnimit, si: armatimi, helmetat, jelekët taktik, dylbitë, busollat, GPS , harta, etj.

Temat kryesore të trajnimit, ka qenë "Vëzhgim dhe zbulim" mirëpo kemi mbajtur trajnime edhe të temave tjera, profesionale. Stafi i Insruktorëve ka qenë shumë i përkushtuar që ne, të arrijmë rezultate sa më të mira, dhe të cilët na kanë afruar mbështetje profesionale, gjatë gjithë kohës. Instruktorët kanë qenë të një niveli të lartë, prej rangut të majorëve dhe nënkolonelëve.

Trajnimin e kemi mbajtur ditën, por, edhe gjatë natës, sipas karakterit të temave të zhvilluara.

Gjatë trajnimit të mbajtur në Kazermën "Atatark" kontingjenti i FSK-së, ka funksionuar si një Togë, me 3 skuadra, si pas strukturës së FSK-së.

Të gjithë pjesëtarët e kontingjentit të FSK-së, kanë shfaqur një disciplinë dhe përkushtim të lartë dhe njëherit kanë arrit rezultate të mira, për këtë të gjithë pjesëtarët e kontingjentit, janë pajisur me certifikata dhe diploma, na thotë në fund toger Shabani.

Edhe ky trajnim dyjavësh, si dhe trajnimet e mëparshme të mbajtura në Turqi, po realizohen në bazë të planit të dalë nga memorandumi i bashkëpunim i nënshkruar në mes të dy ministrive përkatëse.





FORCA JONË

Komandanti i FSK-së certifikoi kadetët e Ushtrisë së SHBA-s dhe të FSK-së





Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të 27 kadetëve të SHBA-së dhe 66 pjesëtarëve të FSK-së, të cilit kanë kryer kursin trejavësh të programit të njohjes së kulturave dhe të komunikimit të gjuhës angleze.
Në ceremoninë e certifikimit të kadetëve, morën pjesë; komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, atasheu ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë, koloneli James Kott, pasi falënderoi stafin e KDS-së dhe gjeneral Cikaqin, për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë oficerë të lartë të FSK-së. Ceremonia filloi me intonimin e himnit të SHBA-ve dhe të Kosovës.
Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, fillimisht përshëndeti Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën që po japin për FSK-në, dhe kadetët e SHBA-s dhe ata të FSK-së, të cilët ishin rreshtuar me rastin e certifikimit të tyre.
Ky trajnim i përbashkët i kadetëve të SHBA-ve dhe të FSK-së, ka pasur tri objektiva, tha fillimisht komandanti i FSK-së. Objektivi i parë, ka qenë që pjesëtarët e FSK-së të marrin njohuri të reja në gjuhën angleze dhe unë jam shumë i bindur, që pjesëtarët e FSK-së, e kanë realizuar këtë objektiv.
Objektivi i dytë ka qenë shkëmbimi i praktikave dhe përvojave të reja dhe po ashtu jam shumë i bindur që pjesëtarët tanë kanë përfituar nga kadetët e SHBA-ve, dhe kanë marrë eksperienca të reja dhe këto do t'i zbatojmë në të ardhmen nëpër njësitet e tyre.
Objektivi i tretë, që unë e shohë si shumë të rëndësishëm, është se ju keni ndërtuar marrëdhënie të mira dhe keni shkëmbyer praktika dhe njohuri të përgjithshme si dhe keni ndërtuar ura miqësie në mes vete.
Ndërsa, atasheu ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë, koloneli James Kott, pasi falënderoi stafin e KDS-së dhe gjeneral Cikaqin, për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë për realizimin e këtij programi në mes të kadetëve të SHBA-së dhe FSK-së, tha: "Ky trajnim jo vetëm që e ka fuqizuar bashkëpunimin mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe FSK-së, por gjithashtu edhe i gjithë komuniteti ka përfituar përmes tri projekteve humanitare të ndryshme, ku kanë marrë pjesë FSK-ja dhe ekipi KULP, gjatë tri javëve të trajnimit në FSK".
Koloneli Kott pasi që falënderoi të gjithë kadetët që kanë marrë pjesë në këtë program të rëndësishëm, ai u shpreh se eksperiencat e tilla ndihmojnë zhvillimin e liderëve për të ardhmen dhe kjo ishte mënyra më e mirë për të shkëmbyer në mes vete përvojën për gjuhën dhe kulturën ndërmjet SHBA-ve dhe FSK-së.
Ai gjithashtu ka falënderua edhe majorin Brown dhe ekipin e tij, që kanë punuar në bashkëpunim me Zyrën për Bashkëpunim të Ambasadës Amerikane, për të shtuar" Për kadetët tanë amerikanë kjo ka qenë një mundësi e shkëlqyeshme e bashkëpunimit me partnerët tanë kosovar, ndërsa për pjesëtarët e FSK-së, kjo ka qenë një mundësi shumë e mirë që të studiojnë dhe praktikojnë gjuhën angleze dhe të mësojnë për kulturën amerikane dhe ushtrinë tonë.
Certifikatat për kadetët e SHBA-ve dhe të FSK-së u ndanë nga: komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, gjeneralmajor Rrahman Rama, atasheu ushtarak i SHBA-ve, në Prishtinë, koloneli James Kott dhe zëvendëskomandanti i KDS-së kolonel Irfete Spahiu.
Programi KULP është një program në kuadër të bashkëpunimit bilateral në mes të Ushtrisë së SHBA-ve, Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Ambasadës Amerikane në Kosovë.
Objektivat e Programit KULP kanë për qëllim që t'ju mundësojnë pjesëtarëve dhe kadetëve të FSK-së të përmirësojnë nivelin e tyre të gjuhës angleze në komunikimin e drejtpërdrejt me kadetët amerikan, të ndërtojnë marrëdhënie miqësore me kadetët e ROTC -së dhe të njihen me sistemin e trajnimit të kadetëve në ROTC. Përmes këtyre objektivave do të vazhdohet edhe më tej bashkëpunimi mes Komandës së Kadeve të Ushtrisë Amerikane dhe FSK-së në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Kosovë.



Intervistë me majorin George David Brown të Ushtrisë së SHBA-s.

Mirëpritja nga FSK-ja ishte e jashtëzakonshme



Gazeta: "Forca Jonë", Cila është përshtypja e juaj nga vizita në Kosovë dhe çfarë mendimi keni për FSK-në?
Major George BROWN: " Mikpritja dhe natyra pranuese e popullit kosovar është sikur mikpritja e një miku, pjesëtar i shërbimit amerikan. Me të vërtetë është një përvojë që ndodh vetëm njëherë në jetë, e mbushur me ngjarje që do të lejnë mbresa, si për kadetët e FSK-së ashtu edhe të SHBA-ve, të cilat do të kenë ndikim të jashtëzakonshëm edhe në vitet në vijim.

Gazeta: "Forca Jonë", Cilat janë përvojat e juaja gjatë trajnimit të përbashkët me FSK-në?
Major George BROWN: Gjate tri javëve që lamë pas, kadetët dhe personeli udhëheqës kanë pasur një mundësi të mrekullueshme që të angazhohen në zhvillime të shumta profesionale për ngritjen e kapaciteteve si: mësimi i gjuhës angleze, vizita e monumenteve të luftës, vizita në kompleksin e kazermës së Brigadës së Reagimit të Shpejtë, si dhe vizita të tjera, duke përfshirë dhe një ftesë personale në një ceremoni martesore tradicionale shqiptare. Komentet kanë qenë të jashtëzakonshme si nga kadetët të FSK-së ashtu edhe nga kadetët e SHBA-ve dhe nga i gjithë personeli i përfshirë. Mirëpritja dhe mbështetja e vazhdueshme nga FSK-ja ishte përtej asaj çfarë ne kemi pritur.

Gazeta: "Forca Jonë", Mesazhi i juaj?
Major George BROWN: Si komandanti i këtij misioni jam i impresionuar tej mase nga përpjekjet dhe përfshirja e pjesëtarëve të FSK-së dhe atyre të Ushtrisë së SHBA-ve. Me suksesin shembullor të misionit KULP (Të kuptuarit e kulturës dhe zotërimit të gjuhës), në mbështetje të FSK-së dhe popullit të Kosovës, shpresoj që ky operacioni do të përsëritet edhe në të ardhmen, duke fuqizuar kështu partneritetin e jashtëzakonshëm në mes FSK-së dhe Ushtrisë Amerikane, për gjeneratat e reja.

Dy togere të FSK-së, dallohen në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst" në Britaninë e Bashkuar



Në ceremoninë e diplomimit, të kadetëve të FSK-së, Mimoza Budeci dhe Manushaqe Nura, në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst" në Britaninë e Bashkuar, morën pjesë ministri i FSK-së Agim Çeku dhe zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama. Togeret e FSK-së, u dalluan për arritje të jashtëzakonshme dhe për këtë, nderohen me çmimin "The Brunei Prize". Për të mësuar më shumë, rreth shkollimit, në këtë Qendër Ushtarake Prestigjioze, intervistuam Mimoza Budecin dhe Manushaqe Nura.

Toger Mimoza Budeci

Forca Jonë: *Cila është Akademia Ushtarake "Sandhurst" ?*
Toger Mimoza Budeci: Akademia Ushtarake Sandhurst, është krijuar për të trajnuar oficerë për të shërbyer në lëmin e artilerisë, inxhinierisë si dhe në lëmin e komunikimit në Ushtrinë Mbretërore Britanike, por, sot Sandhurst është një qendër e zhvillimit të lidershipit ushtarak, jo vetëm për Ushtrinë Britanike por për të gjitha ushtritë e shteteve të ndryshme në gjithë botën.

Forca Jonë: *Cilat kanë qenë perceptimet e juaja të para për këtë qendër ushtarake?*
Toger Mimoza Budeci: Sandhurst, ka një reputacion shembullor, në tërë botën, për këtë arsye edhe perceptimet e mija kanë qenë shembullore.

Forca Jonë: *Në cilin drejtimi e keni kryer trajnimin dhe cilat kanë qenë rezultatet e përgjithshme?*
Toger Mimoza Budeci: Sandhurst, është një qendër e zhvillimit të lidershipit ushtarak, jo vetëm për Ushtrinë Britanike por për të gjitha ushtritë e shteteve të ndryshme në gjithë botën. Sandhurst, është krijuar për të trajnuar oficerë në lëmin e lidershipit ushtarak, trajnim, ky i cili përfshinë, jo vetëm pjesën ushtarake (trajnim në lëmin e këmbësorisë) por, edhe pjesën akademike.



Forca Jonë: *Çfarë mund të na thoni për arritjet profesionale në Akademinë Ushtarake Sandhurst?*
Toger Mimoza Budeci: Përgatitja profesionale që Sandhurst ofron është e një niveli shumë të lartë, nivel ky, i cili , sipas mendimit tim, mund të vlerësohet vetëm nga oficerë të karrierës që kanë një përvojë të gjatë të shërbimit në ushtri. Për mua personalisht ky ishte një rast shumë i mirë për t`u përgatitur dhe për të sfiduar vetën në sferën ushtarake dhe akademike që ofron Akademia Mbretërore-Sandhurst.

Forca Jonë: *Ju jeni nderuar me medalje, diplomë etj. Çka në të vërtet do të thotë kjo për ju ?*
Toger Mimoza Budeci: Unë besoj që të arriturat e mija nuk janë të pakta, por asnjëherë të mjaftueshme për t`u lavdëruar, e aq më pak për t`u vetëkënaqur. Unë do të doja që për rezultatet dhe të arriturat e mija ose edhe ngecjet, pse jo, të tregojë dikush tjetër, jo unë, por do të doja të përmendja disa nga të arriturat në Britani të Madhe. Unë, jam zgjedhur si kadet-ja më e mirë në shkollën e gjuhëve në fazën B, kam fituar medalje në garën për marshim dhe zgjedhje të problemeve të ndryshme (ushtarake), gjithashtu kam qenë e propozuar për t`u zgjedhur si kadeti më i mirë i huaj në Akademi, si dhe në ceremoninë përfundimtare kamë marrë çmimin: "The Brunei Prize", çmim ky i cili i ofrohet kadetit të huaj që tregon performancën më të lartë, në lëmin e studimit mbi luftërat.

Forca Jonë: *Në fund, mesazhi juaj për pjesëtarët e FSK-së?*
Mesazhi im, është:" Suksesi nuk ka sekrete, është vetëm rezultat i përgatitjeve, punës me zell, dhe mësimeve të mësuara nga gabimet". (Colin Powell).

Toger Manushaqe Nura

Forca Jonë: *Cila është Akademia Ushtarake "Sandhurt" ?*
Toger Manushaqe Nura: Akademia Sandhurst është Akademia Ushtarake Mbretërore e Britanisë së Madhe, e cila përkrah Akademisë West Point të amerikanëve njihen si ndër akademitë më të mira në botë. Roli i kësaj akademie është që të nxjerrë oficerë me një nivel të lartë përgatitor që të udhëheqin me trupa, nxjerr liderë të dalluar që janë në gjendje të motivojnë, përgatisin dhe udhëheqin me trupat ushtarake në luftë dhe paqe. Vlen të cekët që në këtë akademi janë shkolluar liderë të njohur dhe pjesëtarë të aristokracisë dhe familjeve ma me nam nga shtetet e mbarë botës.

Forca Jonë: *Cilat kanë qenë perceptimet e juaja të para për këtë qendër ushtarake?*
Toger Manushaqe Nura: Me të arritur në akademi kemi hasur në disa probleme. Problem ka qenë edhe ndërrimi drastik kulturor, gjuhësor, mënyra e jetës dhe punës. Në fillim kemi hasur në shumë keqkuptim si nga ana jonë ashtu edhe nga ana e tyre, por me kalimin e kohës jemi integruar në shoqërinë e tyre, kemi gjetur një gjuhë të përbashkët e kemi arritur në kompromis. Sa i përket akademisë në përgjithësi, kërkesat për çdo gjë kanë qenë shumë më të mëdha. Intensiteti i trajnimit, niveli disiplinor dhe profesional kanë qenë dukshëm më të avancuara se ato me të cilat jemi mësuar. Ku edhe kemi arritur në një farë mënyre të kuptojmë një realitet se sa na duhet ne si FSK të punojmë që të arrijmë një nivel të kënaqshëm për një ushtri që duhet të jetë në gjendje t'i dal zot vendit të sajë. Ne si kadetë të huaj jemi pritur si çdo kadet tjetër që iu është bashkangjitur akademisë. Pritja ka qene e mirë, por siç e do edhe rendi asgjë me e veçantë se pritjet e kadetëve të tjerë, gjë që ka qenë plotësisht e pranueshme nga ana jonë.

Forca Jonë: *Në cilin drejtimi e keni kryer trajnimin dhe cilat kanë qenë rezultatet e përgjithshme?*
Toger Manushaqe Nura: Ne nuk kemi pasur ndonjë drejtim të caktuar pasi që kjo është akademi ushtarake dhe ka për detyrë të aftësojë liderët në të gjitha drejtimet, por do të përmendja që një pjesë e konsiderueshme e trajnimit ka qenë e orientuar në këmbësori, por gjithmonë e gërshetuar me drejtime të tjera siç janë inteligjenca, komunikimi, marrëdhëniet civile-ushtarake, duke përfshirë të gjitha drejtimet.



Objektivi i kësaj akademie është që oficerët t'i nxjerrë me njohuri bazike në të gjitha drejtimet, e pastaj t' i kompletojë ata duke iu ofruar trajnime në drejtimet e përzgjedhura nga ta, në bashkëpunim me përfaqësuesit e drejtimeve që kanë fjalën përfundimtare. Rezultatet kanë qenë jashtëzakonisht të mira pasi që sot unë e ndjejë veten shumë të gatshme që trupave nën udhëheqjen time t'ju ofroj një trajnim të nivelit të lartë, dhe të udhëheq me ta në mënyrë profesionale, kështu duke i kontribuar zhvillimit të përgjithshëm të FSK-së.

Forca Jonë: *Cilat janë arritjet tuaja profesionale në Akademinë Ushtarake Sandhurst?*
Toger Manushaqe Nura: Akademia ka qenë me nivel shumë të lartë profesional. Ka qenë e pajisur me të gjitha gjerat e nevojshme për trajnim, duke filluar nga uniformat dhe pajisjet e duke vazhduar me një staf shumë profesional ku përfshiheshin oficerë me grada deri në gjeneral, doktorë e staf i kualifikuar për mësime specifike. Hartimi i ushtrimeve ka qenë po aq i mirë sa që ngjante me situata reale të luftës. Gjithçka ka qenë shumë mirë e koordinuar dhe standardet e vlerësimit të kadetëve kanë qenë mjaft të lata. Sot unë ndihem me fat që kam pasur mundësi të shkollohem në një akademi kaq profesionale që më bëri të përgatitem aq mirë sa që sot me plot vetëbesim them se sa i përket përgjegjësisë individuale si oficerë ushtarak unë jam në gjendje t'i dal zot vendit tim.

Forca Jonë: *Ju jeni nderuar me medalje, diplomë etj. Çka do të thotë kjo për ju ?*
Toger Manushaqe Nura: Në akademi unë kam pas fatin të jem një nder kadetët e vetëm të huaj që mu është besuar hyrja në reprezentacionin e akademisë për gara atletike të cross country-it në nivel të gjithë Ushtrisë së Britanisë, ku kam marrë medalje për vendin e parë, si fituese e ligës së ushtrisë britaneze pas shumë vitesh. Në një garë tjetër kam marre medalje për vendin e dytë si përfaqësuese e ekipit të akademisë të përberë prej 5 femrash, kjo garë regjionale e cross Country-it. Pas këtyre suksesëve jam shpërblyer nga komandanti i akademisë me full colours që është mirënjohje për kontributin e dhënë. Këto medalje kanë pasur një rëndësi shumë të madhe për mua si përfaqësuese e Kosovës, pasi që mua më është besuar hyrja në grupin reprezentues të akademisë prej 5 femrash, duke lënë mbrapa shumë femra të gjeneratës sime dhe dy gjeneratave më të reja. Kjo besoj që ka dëshmuar nivelin përgatitor të oficerëve të Kosovës të diplomuar në QSU duke pasur parasysh nivelin dhe kushtet shumë më të mira të ushtrisë britaneze.

Forca Jonë: *Në fund, mesazhi juaj për pjesëtarët e FSK-së?*
Toger Manushaqe Nura: Kur duam të punojmë le t'i drejtojmë sytë kah vendet e zhvilluara dhe të shohim rezultatin për të cilat po punojmë. Kur të fillojmë ankesat le t'i drejtojmë sytë kah vendet e pazhvilluara që ne i lamë mbrapa dhe të motivohemi për më shumë. Andaj unë ju kërkoj dhe ju lus për më shumë punë, përkushtim, motivim, e më pak ankesa. Ne kemi një të kaluar të hidhur e një amanet, dhe kemi një të ardhme për të cilën duhet të punojmë shumë.

FORCA JONË

Në KDS certifikohen 30 rekrutë të FSK-së nga radhët e komuniteteve

(Vijon nga faqja parë)

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), në Ferizaj, më 23 gusht 2013, u mbajt ceremonia e certifikimit të rekrutëve të gjeneratës së parë, për këtë vit, të kursit bazik, për rekrutët aktivë, nga radhët e komuniteteve.

Kursi bazik ka zgjatë 9 javë dhe është realizuar në tri module me 20 lëndë mësimore, nga instruktorët e Qendrës së Stërvitjes Bazike të KDS-së.

Në mesin e rekrutëve, 26 pjesëtarë janë nga komuniteti serb, dy të atij boshnjak, një turk dhe një ashkali.

Në ceremoni morën pjesë: ministri i FSK-së Agim Çeku, zëvendësministrat: Muhamet Latifi, Bejtush Gashi dhe Sllavisha Filipoviq, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendës ambasadorja e SHBA-ve, zonja Kelly Degnan, atasheu ushtarak i SHBA-ve, koloneli James Kott, ambasadori i Britanisë së Madhe Ian Kliff, gjenerali i KFOR-it, gjeneral brigade Salvatore Carta, atashe ushtarak të kredituar në Kosovë, gjeneralë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, të NAT-it, familjarë dhe të afërm të pjesëtarëve të rekrutëve, etj.

Pas fjalës së hapjes së ceremonisë, të pranishmit i pari i përshëndeti komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili tha: "Kjo është një ditë e veçantë për të gjithë ne, pasi që diplomimi edhe i 30 rekrutëve të rinj të FSK-së, shënon edhe një hap drejt zhvillimit të FSK-së. Por, ajo çka e bënë këtë ditë më të veçantë, është fakti që të sapodiplomuarit janë nga radhët e komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë". Me këtë rast, duke iu drejtuar rekrutëve, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, u shpreh:"Të nderuar ushtarë të sapodiplomuar, komandantët dhe instruktorët tuaj, më kanë treguar se gjatë trajnimit, jeni angazhuar maksimalisht dhe kjo dëshmon për motivin e juaj, për të studiuar, me çka keni arritur rezultate të shkëlqyeshme gjatë procesit të trajnimit.

Gjatë stërvitjes bazike, ju keni treguar shpirtin tuaj fitues dhe dëshirën për t'u dalluar. Ju keni demonstruar: kreativitetin, motivimin dhe këmbënguljen për të kryer çdo detyrë apo punë që ju është besuar. Për më shumë, ju keni mësuar ta ndihmoni dhe përkrahni njëri-tjetrin. Ju keni mësuar që si individ ka kufizime në shkathtësitë e juaja, por se çdo gjë është e mundur, kur punoni në grupe. Këto cilësi do të jenë thelbësore kur shërbeni në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Gjatë trajnimit bazik ju keni mësuar për kreativitetin, vetëbesimin dhe vetëdijesimin. Çfarë është më e rëndësishme, ju keni pasur mundësinë e testimit të personalitetit dhe karakterit tuaj. Keni pasur një mundësi unike për të identifikuar shkathtësitë dhe për të zhvilluar burimet tuaja të brendshme".

Komandanti i FSK-së, duke vlerësuar shkollimin e rekrutëve, si shumë me rëndësi, kërkoi angazhim për t'i çuar njohuritë e marra më lartë: "Ky kurs i ka sfiduar mundësitë e juaja personale, por asnjëherë nuk jeni dorëzuar. Në vend të kësaj, ju e keni shtyrë veten në kufijtë e mundësive tuaja, madje edhe përtej tyre. Unë e di që për disa nga ju është dashtë një guxim i vërtet; guximi për ta zgjedhur rrugën e juaj dhe për ta realizuar ëndrrën tuaj, pa marrë parasysh se



çfarë të tjerët mund të mendojnë. Gjeneral Kastrati, falënderoi prindërit dhe familjarët e rekrutëve të cilët kanë meritat më të mëdha, për shkollimin e tyre".

ndërsa, ministri i FSK-së, Agim Çeku, në fjalën e tij tha: "Kjo është një ditë e veçantë për juve dhe për FSK-në, sepse ju e kryet trajnimin bazik dhe për FSK-në se ajo po fiton më shumë me pjesëmarrjen e juaj. Ju që nga sot, po bëheni më të vlefshëm jo vetëm për vete, për familjet e juaja, por edhe për vendin, për Kosovën, por në veçanti edhe për komunitetin tuaj.

Ju me vendimin për t'iu bashkuar FSK-së i ndryshuat shumë perceptime të gabuara, i thyet disa barriera të vjetra dhe hapët rrugët që me bashkëvendësit të bëheni ushtarë të Kosovë. Unë, shtoi ministri Çeku, së bashku me të gjithë jam këtu për t'iu përgëzuar, për vendimin e drejt dhe të guximshëm që e keni marrë që të bëheni pjesë e rreshtit të gjatë dhe shumë etnik të FSK-së. Ministri falënderoi komandantët dhe instruktorët,të cilët me shumë kujdes dhe shumë profesionalizëm, e udhëhoqën me sukses këtë trajnim bazik, me të cilën sot krenohemi të gjithë.

Në fund, ministri Çeku pasi përshëndeti prindërit dhe familjarët të cilët iu ofruan mbështetje djemve dhe vajzave e tyre në marrjen e këtij vendimi të rëndësishëm, ushtarëve të rinj, u tha: "Ju keni zgjedhur një profesion të veçantë, por një profesion shumë fisnik, dhe duhet ta dini që jeni të mirëpritur në FSK. Në FSK ka shumë komunitete por për të gjithë ka një mision të njëjtë, detyrat janë të njëjta, kërkesat janë të njëjta ndaj të gjithëve dhe të gjithë janë të barabartë. Ju duhet të jeni ata çka jeni, por në radhë të parë duhet të jeni ushtarë të Kosovës, të jeni të bindur ndaj oficerëve të juaj, ndaj FSK-së, njësitit tuaj, ndaj Kosovës".

Në emër të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përshëndeti zëvendës ambasadorja zonja Kelly Degnan, e cila tha se dua ta përgëzojë këtë grup burrash dhe grash në mbarim të trajnimit themelor dhe hyrjen në Forcën e Sigurisë së Kosovës. "Ky ka qenë program i vështirë trajnimi, që ka testuar përkushtimin e juaj, qëndrueshmërinë dhe aftësitë në shumë mënyra dhe ju keni kaluar me sukses. Sot ne nderojmë fillimin e karrierës suaj në shërbim të bashkëqytetarëve tuaj. Ne e admirojmë shumë dhe e respektojmë zgjedhjet që ju keni bërë disa prej tyre shumë të vështira. Si pjesë e FSK-së, ju me të vërtet jeni pjesë e së ardhmes së Kosovës, si një shtet shumetnik, demokratik. Populli i SHBA-ve ndanë përkushtim tuaj ndaj këtyre vlerave dhe ne jemi krenarë që jemi miku juaj i besueshëm dhe partneri juaj i përkushtuar".

Nëpërmjet shërbimit tuaj, shtoi zonja Degman "ju jeni një shembull i fortë i një të ardhme shpresëdhënëse për pjesëtarët e komuniteteve tuaja. Ju do të frymëzoni të tjerët për të shërbyer me dinjitet dhe krenari. Dhe ju do të hapni rrugën për ata që ju ndjekin juve për të qenë të mirëpritur në FSK". Ndërtimi i një Force tha zëvendës ambasadorja e SHBA-ve, që përfaqëson tërë Kosovën do të kërkojë një përpjekje të qëndrueshme . Ministria e FSK-së ka bërë përparime të mëdha në shtrirjen e saj në komunitete të ndryshme të Kosovës, vetëm duke punuar së bashku do ta bëni FSK-në, një forcë që përfaqëson dhe është e mbështetur nga të gjithë qytetarët e Kosovës.

Për të përfunduar, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës i bashkohen kësaj krenarie dhe ju përgëzojë për përkushtimin ndaj komuniteteve, vendit tuaj dhe një të ardhme të sigurt për gjithë Kosovën.

Ndërsa, zëvendësministri i FSK-së, Sllavisha Filipoviç, fillimisht ka përshëndet të gjithë pjesëmarrësit në këtë ceremoni të rekrutëve si dhe familjarët e tyre, të cilët kanë përkrahë bijtë dhe bijat e tyre që me sukses ta kryejnë kursin bazik. Rekrutët që nga dita e sotme do të jenë pjesëtarë të FSK-së dhe që nga sot, do t'i ndihmojnë të gjithë qytetarët e Kosovës, për të shtuar, se: "ju, do t'i keni të gjitha rrugët e hapura drejt ngritjes profesionale.

Si dëshmi për këtë, është edhe fakti se tre nga rekrutët që kanë treguar rezultate të shkëlqyeshme do t'i vazhdojnë studimet në Akademinë Ushtarake në Shkup.

Regrutët më të mirë për rezultate të shkëlqyeshme dhe sjellje shembullore, gjatë kryerjes së kursit bazik ishin: Daniell Jovanoviq dhe Almir Haliloviç.

Në fund, rekrutët e sapodiplomuar, solemnisht dhanë betimin!



Intervistë me pjesëtarë të rinj të komuniteteve në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Krenohemi që jemi pjesëtare të FSK-së

Ushtare Jasmina Shabanoviq



Jasmina Shabanoviq është pjesëtare e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së) në Batalionin e Dytë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH) në Istog. Ajo është e sistemuar në Kompaninë 2 C, si administratore e kësaj kompanie. Ajo na tregoi me kënaqësi dhe entuziazëm për momentet kur ka vendosur të bëhet pjesë e FSK-së. "Sapo kam dëgjuar për konkursin e FSK-së i kam thënë vetes se dua ta provojë dhe të shoh se sa mund t'ia dal të jem pjesë e një profesioni, siç është profesioni i ushtarakut, i cili dikur është cilësuar më shumë si profesion që mund ta kryejnë vetëm meshkujt. Unë, me plot përgjegjësi u them të gjithëve se edhe femrat janë të forta dhe mund ta përballojnë çdo vështirësi që iu del në jetë" tha ajo. Tek Jasmina asnjëherë nuk mungoi motivi dhe dashuria e madhe për këtë profesion, gjë që e ndihmoi t'i kalojë pa vështirësi të gjitha testet që duheshin kaluar për tu bërë pjesë e FSK-së. Po ashtu edhe mbështetja e madhe e familjes e bënë më të lehtë rrugëtimin e saj. "Familja më ka përkrahur shumë në të gjitha aspektet si në kohën kur kam qenë duke u testuar po ashtu edhe gjatë periudhës së trajnimit bazik. Sigurisht se fillimi nuk ishte i lehtë, sidomos ishte stresuese periudha e testimit, por me përkrahjen e jashtëzakonshme të familjes sime unë arrita t'i kaloj të gjitha testet me rezultatet e kërkuara që ishin kriter për t'u pranuar në FSK. Në trajnim bazik kemi treguar se femrat janë të forta po aq sa meshkujt, madje në shumë raste meshkujt janë ankuar më shumë se femrat" shprehët Jasmina".

Pas përfundimit të trajnimit bazik Jasmina është sistemuar në Batalionin e Dytë të BRSH-së në Istog, ku punon si administratore e zyrës në Kompaninë 2 C."Në fillim ka qenë pak e vështirë puna në FSK, për shkak të mosnjohjes së gjuhës shqipe, por me kalimin e kohës dhe me përkrahjen e kolegëve fillova ta mësoj gjuhën dhe kjo gjë më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Tani çdo ditë e më mirë po e bëj punën time, sepse kam mësuar a të shkruaj në gjuhën shqipe raporte, plane dhe të kryej punë të tjera administrative të personelit të kompanisë" tha Jasmina. Jasmina i takon komunitetit boshnjak dhe asnjëherë në punën e saj nuk ka vërejtur ndonjë dallim që është bërë mes saj dhe pjesëtarëve tjerë të FSK-së. Përveç punës në FSK Jasmina nuk bënë ndonjë punë tjetër. Pjesën tjetër të ditës ajo e shfrytëzon me familjen dhe me shoqërinë. Ajo kujton kohën kur për herë të parë e veshur me uniformë kishte takuar shoqërinë e saj dhe këtë ndjenjë nuk heziton ta ndaje edhe me ne." Shoqëria ime në fillim ka shfaqë rezerva për pranimin tim në radhët e FSK-së, por sapo me kanë parë të veshur me uniformë me kanë përgëzuar dhe më kanë përkrahur. Ata shpeshherë gjatë bisedave me shoqëri me marrin si shembull dhe me konsiderojnë me fat qe jam pjese e kësaj force" Gjatë bisedës me ne, Jasmina, përmend edhe dy raste qe i kane lënë mbresa gjatë shërbimit të saj në FSK, si: pjesëmarrja në togun e FSK-së me rastin e shënimit të 100 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë, e cila për të ishte e jashtëzakonshme, si dhe pjesëmarrjen në marshimin që u zhvillua në Holandë, i cili po ashtu u vlerësua me rezultate të mira. Ja si shprehet ajo " Kam marrë pjesë në përvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ajo ndjenjë për mua ka qenë më e mira që më ka ndodhur deri me tani gjatë jetës sime, por ndjenjë e veçantë ka qenë edhe pjesëmarrja në marshimin në Holandë, ku kemi marrë pjesë 30 pjesëtarë të FSK-së në mesin e tyre 4 femra dhe njëra nga to ka qenë edhe komandante togu. Kemi marshuar 160 km për 4 ditë, por nuk kemi pasur ngecje ngase ishim të përgatitur paraprakisht dhe të kalitur për çdo sfidë". Suksesin e arritur në këto dy ngjarje e përkufizon me bashkëpunimin e mirë në mes të kolegëve si dhe më përkrahjen e vazhdueshme që i bëjnë njëritjetrit qoftë në triumfe, por edhe në vështirësi.

Jasmina asnjëherë nuk ka menduar që ta ndërroj punën në FSK me ndonjë punë tjetër, sepse sipas saj gjithçka që ka të bëjë më FSK-në është e mirë dhe e pazëvendësueshme. " Nuk kam menduar asnjëherë se çka do të punoja nëse nuk do të isha pjesë e FSK-së, por meqenëse kam përfunduar studimet për biznes sigurisht që do t'i përkushtohesha kësaj fushe, përfundon Jasmina Shabanoviq, pjesëtare e FSK-së.

Ushtare Donjeta Mehmeti



Ushtarja e FSK-së Donjeta Mehmeti është njëra nga vajzat e reja të Kosovës që i është bashkuar FSK-së që nga data 23.06.2013. Ajo është sistemuar në Batalionin e Xhenios (BXH) si furnizuese e administratës së këtij batalioni. Është nga Gjilani dhe jeton në Prishtinë. Ka të kryer gjimnazin, drejtimi Matematikë-Informatikë dhe tash është në përfundim të Fakultetit Ekonomik drejtimi Banka , Financa dhe Kontabilitet në Universitetin e Prishtinës. Para se të aplikojë në FSK, Donjeta ka punuar mësuese, por gjithmonë brenda saj çdo ditë e më tepër ndizej dëshira për t'u bërë pjesë e kësaj force. Këtë dëshirë të Donjetës e mbështet fuqishëm edhe e ëma e saj, e cila duke njohur mirë personalitetin e së bijës beson se puna në FSK është ndër punët që i përshtatet më së miri karakterit të saj. Donjeta si në familje ashtu edhe tek të afërmit dhe njerëzit që e njohin shquhet për disiplinë dhe jetë të rregullt , andaj me shumë dëshirë është bërë pjesë e FSK-së. Ajo e përshkruan me pak fjalë dëshirën e saj."Sa herë që shkoja në Gjilan , ndaloja tek kazerma dhe shikoja pjesëtarët e FSK-së në uniformë. Me pëlqente jeta që bënin, me pëlqente disiplina dhe rregullat që kishin ata dhe ëndërroja vazhdimisht qe një ditë të jem edhe unë pjesë e kësaj jete me rregulla dhe disiplinë, sepse jam edukuar në një familje që respektohen rregullat dhe disiplina" shton ajo. Donjeta Mehmeti edhe pse ka vetëm një javë që i është bashkuar FSK-së, ajo tashmë ndjehet sikur ka kohë që është pjesë e saj. Donjeta nuk ngurron të na tregoi edhe për periudhën e trajnimit bazik dhe për vështirësitë e saj të para gjatë kësaj periudhe. Po ashtu me plot emocion dhe entuziazëm përshkruan momentet e diplomimit duke ndarë me ne ndjenjën e saj, jo vetëm të lumturisë por edhe të krenarisë, gjatë këtyre momenteve të paharruara për të . Donjeta me gëzim na rrëfen edhe momentin kur babai i saj kishte postuar në rrjetet sociale foton e saj gjatë procesit të trajnimit me mbishkrimin "Krenohem me Donjetën". Ajo nuk e fshehë asnjëherë ndjenjën e krenarisë që është bërë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe po ashtu pret me padurim që nesër të bëhet pjesë e misioneve të saj jashtë vendit, gjë që është dëshirë e madhe edhe e babait të saj,thotë në fund të fjalës së saj Donjeta.

FSK-ja hapi rrugën që lidhë disa fshatra malore të komunës së Hanit të Elezit

Shiritin e përurimit të rrugës e pren komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma dhe komandanti i Batalionit të Xhenios, nënkolonel Zejnë Prokshi



Në ceremoninë e përurimit morën pjesë; komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kryetari i komunës, Rufki Suma, gjeneral brigade, Imri Ilazi, nënkolonel Zejnë Prokshi, komandant i Batalionit të Xhenios, si dhe oficerë dhe qytetarë të komunës dhe fshatrave të kësaj ane.

Rruga e hapur nga Forca e Sigurisë së Kosovës me një gjatësi prej 7.6 kilometra lidh fshatrat si, Paldenicë, Gorancë, Rezhancë, Neqavc, Pustenik dhe Dëmjak. Projekti është realizuar në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të Ministrisë së FSK-së dhe Komunës së Hanit të Elezit.



Me këtë rast, komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, fillimisht ka falënderuar pjesëtarët e Batalionit të Xhenios, për punën e madhe që kanë bërë edhe në këto kushte të papërshtatshme për punë, për të shtuar se; "Ky projekt është në vazhdën e shumë projekteve që FSK-ja ka bërë në pesë vitet e fundit. Unë nuk mund t'i numëroj një nga një për arsye se janë të shumta me qindra, por kryesorja është se FSK-ja po dëshmon se është afër qytetarit, afër të gjitha komuniteteve për t'ua lehtësuar jetën atyre dhe për t'ju krijuar mundësi për zhvillimin e biznesit edhe në fshatrat e tyre. FSK-ja do të vazhdojë edhe me tutje që të jap kontributin e vet me të gjitha kapacitetet e veta që të realizojë projekte, qofshin ato rrugë, ura apo projekte tjera për qytetarët e Kosovës. Ne këto ditë kemi edhe projekte tjera që do t'i përfundojmë, por unë si komandant i përgëzoj pjesëtarët e FSK-së për këtë projekt që e kanë kryer para kohe", ka thënë Kastrati.

Ndërsa, në anën tjetër kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma duke falënderuar pjesëtarët e FSK-së, për realizimin e këtij projekti para kohe, ka thënë se projekti i zgjerimit dhe hapjes së rrugës për këto fshatra ndihmon të gjithë qytetarët e kësaj ane për të pasur qasje më të lehtë me qendrën komunale, pasi deri më tani kjo rrugë ka qenë e pakalueshme.

"Kjo rrugë ka rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët e Hanit të Elezit, konkretisht për banorët e këtyre fshatrave, pasi që ky fshat ka qenë i zbrazur qysh nga koha e paraluftës, por me hapjen e kësaj rruge është bërë lidhja, në rend të parë, me fshatrat Paldenicë-Neqavc nga Neqavci në Dërmjak. Sigurisht se kjo rrugë do t'ju mundësojë banorëve të kësaj anë që të rikthehen në fshatrat e braktisura dhe të merren me bujqësi dhe blegtori", tha në fund të fjalës së tij Suma.

Kjo rrugë është hapur me një afat rekord, ku vetëm për një muaj kanë përfunduar të gjitha punët e këtij projekti.

Nxënësit shqiptarë nga diaspora vizitojnë kazermën e FSK-së "Ushtarët e NATO-s" në Istog







Me rastin e organizimit ,,Ditët e Diasporës 2013" nga Ministria e Diasporës dhe në mbështetje të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, një grup i fëmijëve nga diaspora i përbërë prej 37 vetash e vizituan kazermën e FSK-së ,,Ushtarët e NATO-s" në Istog.

Ky është grupi i dytë i nxënësve nga diaspora, të cilët të shoqëruar nga mësuesit dhe familjarë e tyre, që vizitojnë kazermën e FSK-së, në Istog.

Fillimisht, nxënësit dhe familjarët e tyre u pritën nga stafi komandues i Batalionit të Dytë të BRSH-së, nënkolonel Mehmet Lladrovci dhe majorët: Fejzë Bujupi, Enver Beqiri etj.

Ndërsa, kapiten Demë Lulaj i njoftoi nxënësit për misionin e BRSH-së, për aktivitetet e tyre, trajnimet dhe infrastrukturën e BRSH-së.

Nxënësit nga diaspora përcollën nga afër disa nga aktivitetet e përditshme, që demonstruan pjesëtarët e FSK-së. Ata po ashtu vizituan edhe ambientet e punës së pjesëtarëve të FSK-së dhe u ndanë shumë të kënaqur me paraqitjen e këtyre pjesëtarëve.

FORCA JONË

* * * Viti II • Nr. 17 • Tetor 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Maqedonia do ta mbështetë FSK-në për anëtarësim në të gjitha nismat rajonale



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku me bashkëpunëtorë qëndroi për vizitë zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë me ftesë të homologut të tij, ministrit të Mbrojtjes, Talat Xhaferi.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku u prit me nderime të larta shtetërore në Ministrinë e Mbrojtjes. Gjatë takimit kokë më kokë,të dy ministrat diskutuan për zhvillimet e përgjithshme si dhe për fushat e bashkëpunimit të dyanshëm. Gatishmëria për të vazhduar me shembullin pozitiv për bashkëpunimin e ndërsjellë të suksesshëm dhe të frytshëm, si dhe gjetjen e mënyrave për intensifikimin e mëtejmë, ishin temat për të cilat diskutuan gjatë takimit të sotëm zyrtar të dy ministrat: Çeku dhe Xhaferi.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku në konferencën për shtyp, tha se; një nga shtyllat e tij si ministër janë marrëdhëniet e mira dhe konstruktive me vendet tona fqinje. Bashkëpunimi me Maqedoninë, është një shembull i gjallë i besimit tim të fortë se ne, vendet e Ballkanit Perëndimor, duhet të bashkëpunojmë dhe të punojmë së bashku, për të shtuar se Kosova dhe Maqedonia nuk ndajnë vetëm kufijtë e zakonshëm, por edhe synimet e përbashkëta, si: promovimi i paqes rajonale dhe globale; stabiliteti, integrimi euroatlantik; vullneti i fortë për të kontribuar në NATO, BE dhe në misionet e OKB-së; forcimi i vazhdueshëm i partneritetit strategjik me shtetet anëtare; miqësia dhe bashkëpunimi i plotë me vendet fqinje.

Gjithashtu, ministri Çeku, tha se, po punojmë për zhvillimin e FSK-në, si forcë për të mirë, që është e besueshme, e dobishme dhe kompetente, dhe ne jemi mirënjohës për Maqedoninë për mbështetjen e saj të fortë dhe ndihmën e dhënë për FSK-në. "Maqedonia është gjithashtu një mbështetëse e fortë e Kosovës edhe në skenën rajonale dhe ndërkombëtare. Republika e Maqedonisë, shtoi ministri Çeku është shumë e interesuar dhe ka bërë dhe po bën përpjekje që Kosova të bëhet anëtare e plotë e Kartës SHBA-Adriatik, pjesëmarrje e cila Kosovës i hap rrugë për integrimin euroatlantik.

Bashkëpunimi në mes të MFSK-së dhe FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë dhe Forcat e Armatosura të RM-së është shumë dinamik dhe mbulon shumë fusha të bashkëpunimit; vizita zyrtare, bisedimet e ekspertëve, seminare, punëtori, ekspertizë arsimi dhe trajnimi. Ne, vazhdoi ministri Agim Çeku, kemi në dispozicion Zonën e Krivollakut për trajnime për nevojat e FSK-së, dhe për këtë mundësi u jemi mirënjohës sepse kjo ndihmon për të ndërtuar kapacitetet e FSK -së.

Gjatë vizitës së ministrit të FSK-së në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, ministri Çeku dhe ministri Xhaferi nënshkruan Protokollin për Bashkëpunim në trajnim ushtarak dhe Aneksin e Protokollit mbi edukimin e kadetëve të Kosovës në Akademinë Ushtarake të Republikës së Maqedonisë. Në Akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostolski" janë duke ndjekur studimet 7 kadetë nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Maqedonisë në fushën e sigurisë mund të shihet nga vendet e tjera si një shembull i mirë i marrëdhënieve dypalëshe.

Në kontekst të sferës së bashkëpunimit, ministri i Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi tha se gjatë bisedimeve është diskutuar lidhur me aktivitetet e përbashkëta stërvitore në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe Kosovës, më pas mbi bashkëpunimin lidhur me shfrytëzimin e kapaciteteve të vendit tonë, me theks të veçantë në Qendrën Rajonale për Marrëdhënie me Publikun, që kohëve të fundit u shndërrua në Qendër Partneriteti për Paqe, mbi Qendrën për Trajnime të Pilotëve si një element i cili është me rëndësi të madhe për zhvillimin e kapaciteteve dhe nënkuptohet për Akademinë Ushtarake, ku edhe tani arsimohen pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në aspekt të bashkëpunimit rajonal, ministri i Mbrojtjes së Maqedonisë, z.Talat Xhaferi theksoi se duke u udhëhequr nga parimi, se Rajoni do të jetë i plotë, atëherë kur në nismat rajonale do të marrin pjesë të gjitha vendet që e krijojnë atë, kurse Republika e Maqedonisë do t'i japë mbështetje anëtarësimit të Republikës së Kosovës në këto nisma.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, gjatë vizitës zyrtare njëditore në Republikën e Maqedonisë, vizitoi edhe Akademinë Ushtarake, ku u takua me dekanin e AU-së, kolonel Orce Popovski dhe me kadetët nga Republika e Kosovës. Me këtë rast, ministri Çeku mbajti një ligjëratë në Akademinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë.

Në shoqërim të ministrit gjatë vizitës ishin edhe drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi, shefi i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Siguri, nënkolonel Hasan Hoxha si edhe shefja e Zyrës Ligjore të MFSK-së, Krenare Sogojeva-Dermaku.

FSK-ja mban Ushtrimin Fushor "Shqiponja 2"



Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) në fillim të muajit tetor, do të mbaj Ushtrimin Fushor të koduar ,,Shqiponja 2", i cili do të realizohet në disa rajone të Kosovës.

(Vijon në faqe 8)

FSK-ja përuroi urën afër Manastirit të Deçanit

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht Batalioni i Xhenios (BXH) i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO), ka përfunduar punimet e ndërtimit të urës, montazh, në Deçan, afër Manastirit të Deçanit. FSK-ja në këtë projekt është angazhuar me kërkesë të Manastirit të Deçanit. Batalioni i Xhenios në bashkëpunim me KFOR-in (kontingjentet e Suedisë, Italisë, Danimarkës dhe të Francës), janë angazhuar në këtë projekt, që nga data 2-20 shtator të këtij viti. Ministri Agim Çeku dhe Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, përuruan urën e re në Deçan, projekt ky i realizuar në të mirë të komunitetit që jeton në atë lokalitet dhe në mirë të gjithë qytetarëve që kanë interes të lëvizin në atë pjesë të vendit.

Në ceremoninë e përurimit të urës, në Deçan, pos ministrit dhe komandantit të FSK-së, morën pjesë edhe zëvendësministrja e FSK-së, Jasmina Vasiq, komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale, kolonel Ilaz Dërguti, komandanti i Ekipit Këshillues të NATO-s, gjeneralbrigade Norbert Vagner, Sava Janjiqi, (i pari i Manastirit të Deçanit), përfaqësues të Komunës së Deçanit si edhe përfaqësues të tjerë të FSK-së, KFOR-it, KK të Deçanit dhe të Manastirit të Deçanit.

Me këtë rast, Ministri i Çeku, tha se ndjehem jashtëzakonisht i lumtur që realizuam këtë projekt me rëndësi për këtë komunitet, ai njëherësh u shpreh i lumtur që FSK-ja po dëshmon profesionalizëm, ashtu siç duhet, sipas kërkesave teknike me rastin e realizimin të projekteve xheniere.

(Vjon në faqen 5)



Gjeneral Kastrati mori pjesë në Konferencën "Mundësitë për Adresim të Sfidave të Përbashkëta të Sigurisë" në Gjermani

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, që nga data: 30 shtator 2013 e deri më 2 tetor 2013, mori pjesë në punimet e Konferencës së 21-të vjetore, të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës(SHBA) për Evropë dhe Ushtrive të vendeve të Evropës, që u zhvilluan, në Visbaden (Wiesbaden) të Gjermanisë.




Gjeneral Kastrati, në konferencën: "Mundësitë për Adresim të Sfidave të Përbashkëta të Sigurisë", po merr pjesë, me ftesë të gjenerallejtënant Donald Campbell, komandant i Ushtrisë së SHBA-ve, për Evropë.

Kjo konference vjetore ofron mundësi të veçanta për shkëmbime me vendet pjesëmarrëse nga Evropa në të dyja aspektet, atë formale dhe joformale, si edhe mundësi shkëmbimi nga referimet dhe debatet për Sfidat e Përbashkëta të Sigurisë.

Pjesëmarrja e komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati është e rëndësishme, sepse FSK-ja përfaqësohet në nivelin më të lartë dhe është mundësi e mirë për thellimin e bashkëpunimit me Komandën e Ushtrisë së SHBA-ve për Evropë si edhe me krerë të tjerë të Ushtrive të Evropës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën shefin e Shtabit të Ushtrisë Suedeze



Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pritën në takime të veçanta shefin e Shtabit të Ushtrisë së Suedisë, gjeneralmajor Anders Brannstron, i cili shoqërohej nga kolonel Mikael Christoffersson, nënkolonel Curt-Ove Jakobsson dhe major Mikael Wendt.

Me këtë rast, ministri Çeku dhe komandanti Kastrati, e kanë njoftuar, Shefin e Shtabit të Ushtrisë së Suedisë, gjeneralmajorin Brannstron, për të arriturat e FSK-së, për plotësimin e kapaciteteve të plota operacionale, për bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, për trajnimet dhe profesionalizimin e FSK-së, si dhe për procesin e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë në Kosovë.

Në këtë takim ishin të pranishëm; gjeneralbrigade Imri Iljazi, shef i Departamentit të Operatives dhe Trajnimeve, Haxhi Shala, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane dhe nënkolonel Hasan Hoxha nga Departamenti për Siguri dhe Bashkëpunim.

Qëllimi i vizitës ishte vazhdimi i bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkëta, në mes të dy ministrive; Ministrisë së Mbrojtjes së Suedisë dhe të Ministrisë së FSK-së / FSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, vlerësoi lartë nivelin e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve midis dy vendeve dhe theksoi nevojën për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit, duke theksuar se pret edhe në të ardhmen ndihmën e gjithanshme të Suedisë për Kosovën dhe FSK-në. Me këtë rast ai përmendi bashkëpunimin e mirë në fushën e deminimit në mes Ushtrisë së Suedisë dhe FSK-së, në çminimin e parkut "Gërmia" ku ushtria suedeze ka ndihmuar me makineri të rëndë, në eliminimin e rrënojave të mbetura.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Ushtrisë së Suedisë, gjeneralmajor Anders Brannstron, falënderoi ministrin e FSK-së, z. Agim Çekun dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin, për pritjen dhe për bashkëpunimin e dyanshëm. Ai po ashtu ritheksoi se Suedia dhe ushtria e saj do të vazhdojnë të mbështesin edhe në të ardhmen Kosovën dhe FSK-në.

Ministri Agim Çeku dekoroi ambasadorin e Shqipërisë në NATO



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku, në ambientet e Ministrisë së FSK-së, priti në një takim pune, ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në NATO, z. Artur Kuko, i cili shoqërohej nga zëvendësambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Andi Xhoi dhe atasheu ushtarak, kolonel Fiqri Hoxha.

Në takim morën pjesë edhe zëvendësministrat e FSK-së: Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi, Sekretari i Përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zv. komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët: Bashkim Jashari, Gëzim Hazrolli, Zymer Halimi, Imri Ilazi, Nazmi Brahimaj, Enver Cikaqi, kolonel Ilaz Dërguti, Kevin Lynch-drejtor i NAT-it, Haxhi Shala etj.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, për angazhimin e ambasadorit Kuko, në pranimin e Kapaciteteve të Plota Operacionale të FSK-së, e dekoroi me Medalje "për Shërbim Meritor" me motivacionin për kontribut të jashtëzakonshëm dhe përkrahje të vazhdueshme në zhvillimin e FSK-së, në një Organizatë Kompetente të Aftë dhe Profesionale.

Artur Kuko është përfaqësues i përhershëm i Republikës së Shqipërisë, në NATO. Angazhimi i tij, ka qenë kyç për realizimin e Kapaciteteve të Plota Operacionale të FSK-së. Po ashtu progresi dhe arritjet e përgjithshme të FSK-së, janë edhe rezultat i punës së jashtëzakonshme të z. Kuko.

Ambasadori Artur Kuko, pas pranimit të medaljes, falënderoi ministrin Çeku dhe FSK-në. Ai përmbylli fjalën e tij, duke shtuar, se FSK-ja është një histori suksesi, uroj që edhe në të ardhmen, të njohë vetëm suksese të reja drejt anëtarësimit të saj në NATO. Unë, si deri më tani edhe në të ardhmen, do të jem zë i fuqishëm i FSK-së, në NATO.

Jasmina Vasiq, zëvendësministre e FSK-së




Me vendim të kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, zotit Hashim Thaçi, në pajtim me rregulloren për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, mori vendim për emërimin e Znj. Jasmina Vasiq, zëvendësministre e Forcës së Sigurisë në vend të ish- zëvendësministrit të mëparshëm Sllavisha Filipoviq.

Jasmina Vasiq është banore e Graqanicës, është ekonomiste me profesion, ndërsa, e nominuar për zëvendësministre nga partia Demokracia Sociale.

Znj. Jasmina Vasiq, gjatë pranimit të detyrës u zotua se do të angazhohet maksimal në realizimin e detyrave të përgjithshme në Ministrinë e FSK-së

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, vizitë zyrtare në Letoni



Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Shkelzen Sylaj me ftesë të Sekretarit të Shtetit të Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë, zotëri Janis Sarts, qëndroi për vizitë zyrtare, në Letoni.

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkelzen Sylaj, shoqërohej nga nënkolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri dhe Florin Hoxha, sekretar personal i Sekretarit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Mbrojtjes të Letonisë, u prit nga Janis Sarts, Sekretar i Shtetit të kësaj Ministrie.

Sekretari i Përgjithshëm z. Sylaj, vizitoi Forcat e Armatosura të Letonisë, me ç'rast u prit nga kolonel Martins Liberts, komandanti i Regjionit të Parë të Gardës Nacionale të Letonisë.

Në takimet që zhvilloi, Z. Sylaj, u konfirmua gatishmëria e vazhdimit të bashkëpunimit intensiv në mes të dyja ministrive dhe forcave, gjithashtu autoritetet e Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë ofruan përkrahje për MFSK-në dhe FSK-në, gjatë procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë(RSSS).

Sekretari Shkëlzen Sylaj, u prit në një takim pune edhe nga Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Letonisë, zotëri Andrejs Pildegovics, me të cilin biseduan për bashkëpunimin në mes të dyja vendeve, si edhe mbështetjen që po ofron Letonia në anëtarësimin e Republikës së Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë.

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së,z. Shkelzen Sylaj pati një takim pune edhe me shefin e Komisionit Parlamentar për Mbrojtje, Punë të Brendshme dhe Antikorrupsion, si dhe shumë takime me zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, të fushave të ndryshme.

Vizita e delegacionit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës u realizua me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë dhe në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Ministrinë e Mbrojtjes së Letonisë si dhe Forcat e Armatosura të Letonisë.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti atasheun ushtarak të Japonisë



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti sot, në takim pune, drejtorin e Departamentit për Studime të Sigurisë nga Ministria e Mbrojtjes së Japonisë, zotin Tomonori Yoshizaki dhe atasheun e Mbrojtjes së Ambasadës Japoneze në Vjenë të Austrisë, kolonel Tsutomu Sone. Në takim po ashtu të pranishëm ishin edhe drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, zoti Haxhi Shala dhe nënkolonel Hasan Hoxha.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati fillimisht mysafirët i njoftoi për arritjet e FSK-së, për misionin, objektivat dhe zhvillimet më të rëndësishme në FSK-së, arritjen dhe deklarimin e Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO), bashkëpunimin e ngushtë me NATO-n, duke theksuar kontributin e çmueshëm të ekipeve këshilluese të NATO-s në MFSK dhe FSK. Me theks të veçantë ai foli për bashkëpunimin me ministritë e mbrojtjes të shumë vendeve mike dhe anëtare të NATO-s, për pjesëmarrjen në nismat regjionale të sigurisë, pjesëmarrjen në trajnimet dhe ushtrimet e përbashkëta me ushtritë e disa vendeve të rajonit, për procesin e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës (RSSSK) dhe rekomandimet që pritet të dalin nga ky proces për misionin e FSK-së dhe për strukturat e sigurisë së Kosovës në përgjithësi.

Me këtë rast komandant Kastrati edhe një herë falënderoi shtetin e Japonisë për ndihmën e ofruar për FSK-në dhe Kosovën në përgjithësi.

Po ashtu u diskutuan edhe mundësitë e zgjerimit dhe intensifikimit të bashkëpunimit me ushtrinë e Japonisë.

Mysafirët nga Japonia duke shprehur gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, shfaqën interesim për FSK-në dhe perspektivën e saj zhvillimore.

Atasheu ushtarak i Republikës së Shqipërisë u prit nga ministri dhe komandanti i FSK-së



Ministri i FSK-së, Agim Çeku së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin pritën atasheun e ambasadës së Republikës së Shqipërisë, në Kosovë, kolonel Fiqri Hoxha. Atasheu Hoxha në këtë takim shoqërohej nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë Islam Lauka.

Ministri dhe komandanti i FSK-së i uruan mirëseardhje atasheut Hoxha, duke çmuar lartë bashkëpunimin e deritashëm me Ministrin e Mbrojtjes të Shqipërisë dhe Ushtrinë e Shqipërisë.

Me këtë rast, ministri dhe komandanti i FSK-së shprehen gatishmërinë e tyre për të thelluar dhe intensifikuar bashkëpunimin, duke ofruar mundësi dhe vullnet për bashkëpunim në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Ministri Çeku e informoi atasheun Hoxha edhe me proceset aktuale të zhvillimit në FSK-së, objektivat si dhe për procesin e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë në Kosovë (RSSSK).

Atasheu Hoxha, shprehu gatishmërinë për të dhënë kontributin personal në shtimin e bashkëpunimit në mes të dy ministrive, më konkretisht në mes të Ushtrisë së Shqipërisë dhe FSK-së. Kolonel Fiqri Hoxha është atasheu i parë i Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, i emëruar, në Republikën e Kosovës.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org


Një delegacion i Forcave të Armatosura të Gjermanisë vizitë pune në FSK

Me ftesë të ushtruesit të drejtorit të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nënkolonel Hasan Hoxha, nga data: 09-11 shtator 2013, një delegacion nga Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Forcave të Armatosura të Gjermanisë, të udhëhequr nga komandanti Martin Breihaupt, zëvendës-shef i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Forcave të Armatosura të Gjermanisë dhe komandanti Herbert Kraus, nga ky Departament, ka qëndruar për një vizitë zyrtare në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK).

Mysafirët nga Gjermania në MFSK, u pritën nga nënkolonel Hasan Hoxha dhe gjeneralbrigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK.

Qëllimi i vizitës së delegacionit nga Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Forcave të Armatosura të Gjermanisë, ka qenë vazhdimi i bashkëpunimit si dhe diskutimi dhe draftimi i Programit Vjetor të bashkëpunimit për vitin 2014, ndërmjet dy vendeve. Ky program përfshin realizimin e vizitave, organizimin dhe mbajtjen e seminareve me qëllim të shkëmbimit të përvojave në fusha të ndryshme të mbrojtjes.

Delegacioni Ushtarak i Gjermanisë, gjatë qëndrimit FSK, ka realizuar një varg vizitash pune në Komandën e Forcave Tokësore dhe në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, ku janë pritë nga shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, dhe komandanti i Qendrës për Studime Universitare, major Avni Kiqina.



30 oficerë të KFOR-it vizituan kazermën e FSK-së "Ushtarët e NATO-s" në Istog



Në kuadër të bashkëpunimit në mes Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe KFOR-it, për një vizitë pune, në kazermën e FSK-së "Ushtarët e NATO-s" në Istog, qëndroi një delegacion prej 30 oficerësh (Lider kyç sipas hierarkisë ushtarake) të KFOR-it.

Grupin e oficerëve të KFOR-it e priti shefi i Shtabit të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), nënkolonel Jeton Dreshaj, i cili me këtë rast e njoftoi delegacionin e Liderëve Kyç, me misionin, me strukturën, me trajnimet dhe me të arriturat e përgjithshme të BRSH-së.

Më pastaj, oficerët e KFOR-it, vizituan hapësirat e Komandës së BRSH-së, si dhe objektet tjera përcjellëse brenda kazermës, ku takuan stafin udhëheqës të sektorëve të FSK-së. Ata njëherësh u interesuan edhe për punën e përgjithshme të departamenteve të BRSH-së.

Kjo vizitë dhe vizitat e mëparshme janë të rregullta dhe mbahen me qëllim të thellimit të bashkëpunimit të dyanshëm në mes të FSK-së dhe KFOR-it.

Grupi i Liderëve Kyç të KFOR-it, ishte i përbërë nga oficerë të rangjeve të ndryshme nga të gjitha ushtritë pjesëmarrëse në misionin e KFOR-it, në Kosovë.

Një delegacion i KFOR-it u prit nga ministri dhe komandanti i FSK-së

Ministri dhe komandanti i FSK-së, Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastratin, kanë pritë në takime të ndara, një delegacion të KFOR-it, të prirë nga shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s, për FSK-në, gjeneralbrigade Salvatore Carta (i cili ka përfunduar mandatin e tij) dhe shefin e ri të Ekipit Këshillues të NATO-s, gjeneralbrigade Norbert Wagner.



Ministri dhe komandanti i FSK-së, me këtë rast, falënderuan shefin e Ekipit Këshillues të NATO-s, për FSK-në, gjeneralbrigade Salvatore Carta, për përkrahjen dhe mbështetjen e FSK-së, në përmbushjen e kapaciteteve të plota operacionale.

Ministri dhe komandanti i FSK-së i dëshiruan mirëseardhje shefit të ri të Ekipit Këshillues të NATO-s, misioni i të cilit është këshillimi profesional për FSK-në, gjatë viteve në vijim deri në anëtarësimin e FSK-së në mekanizmat e NATO-s.



Shefi i ri i Ekipit Këshillues të NATO-s, gjeneralbrigade Norbert Wagner, afroi gatishmërinë për të punuar ngushtë me stafin komandues të FSK-së në realizimin e objektivave dhe misionit të FSK-së.

Zyrtarizohet baza e të dhënave për menaxhimin e personelit të MFSK/FSK-së



Në ambientet e Kompanisë së Komunikimit të FSK-së, në kazermën "Adem Jashari", komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me zëvendëskomandantin e FSK-së, njëherësh edhe komandant i Komandës së Forcës Tokësore (KFT, gjeneralmajor Rrahman Rama, bënë zyrtarizimin e bazës së të dhënave për menaxhimin e personelit të MFSK-FSK-së.

Drejtori i Departamentit të Personelit në Ministrinë e FSK-së, kolonel Skënder Zhitia, për realizimin e këtij projekti, tha se:"Në kuadër të projektit; Sistemi për Menaxhimin e Informacionit (SIM), Departamenti i Personelit së bashku me Departamentin e Sistemit të Komunikimit dhe Informacionit të MFSK/FSK, pas një pune sistematike 6 mujore, kanë zhvilluar bazën e të dhënave për menaxhimin e personelit. Baza e të dhënave është zhvilluar me forcat vetjake, nga oficerët e FSK-së, zyrtarët e personelit dhe të departamentit të komunikimit.

Qëllimi i krijimit të bazës së të dhënave është më rëndësi për menaxhimin e personelit të FSK-së.

Zyrtarizimin e bazës së të dhënave të parët e bënë komandanti dhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe gjeneralmajor Rrahman Rama.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ka përgëzuar Departamentin e Personelit për angazhimin dhe punën e palodhshme në krijimin e bazës së të dhënave dhe menaxhimin e personelit e cila është shumë e rëndësishme për përcjelljen e zhvillimit të karrierës së pjesëtarëve të MFSK-së/ FSK-së.

Zëvendësministri i FSK-së mori pjesë në takimin "Karta e Adriatikut" në Mal të Zi

Me ftesë të zëvendësministrit të Mbrojtjes së Malit të Zi, z. Ivan Masuloviç, zëvendësministri i FSK-së, z. Bejtush Gashi së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Politika dhe Plane të MFSK-së, z. Haxhi Shala, kanë marrë pjesë në Takimin e Drejtorëve të Politikave të Mbrojtjes të Kartës së Adriatikut, që u mbajt në kryeqytetin e Malit të zi, në Podgoricë.

Ky takim ishte një mundësi e shkëlqyer për të diskutuar mbi racionalizimin dhe prioritetet e projekteve të përbashkëta të rajonit, si dhe mundësitë për pjesëmarrje të përbashkët në Afganistan, në periudhën pas ISAF-it (Forca Ndërkombëtare për Ndihmë dhe Siguri).



Solemnisht dhanë betimin kadetët e rinj të FSK-së





Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcës Tokësore (KFT në Prishtinë, u zhvillua ceremonia e dhënies së betimit dhe fillimit të vitit të ri akademik, 2013-2014, të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare (QSU) të FSK-së, Gjenerata 2017.

Në ceremoninë e betimit morën pjesë: ministri i MFSK-së, Agim Çeku, zëvendësministri Bejtush Gashi, zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, përfaqësues të SHBA-ve, të Ekipit Këshillues të NATO-s (NAT-it), gjeneral brigade Enver Cikaçi, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ushtarakë të tjerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë si dhe familjarë të kadetëve dhe të ftuar të tjerë.

Qendra për Studime Universitare e FSK-së është themeluar në vitin 2005, si Institucion Edukativo-Arsimor. Në këtë qendër deri më tani kanë kaluar nëntë gjenerata, prej të cilave pesë gjenerata kanë diplomuar dhe po veprojnë në kuadër të njësive të FSK-së, ndërsa, katër gjenerata po shkollohen momentalisht.

Ceremonia filloi me parakalimin e kadetëve të QSU-s.

Betimin e kadetëve e përshëndeti ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku, i cili fillimisht u shpreh: "Sot, jemi këtu për ju. Kjo është një ditë e veçantë dhe një fillim i ri, për ju, andaj jemi për t'ju uruar një fillim të suksesshëm, një shkollim të mbarë. Ju kadetë të Kosovës duhet të jeni krenar, se në mesin e 700 kandidatëve (të rinjve dhe të rejave) që kanë aplikuar për të qenë në këtë rresht, ju jeni përzgjedhur më të mirët, dhe ishit më të mirët në mesin e tyre.

Ju që nga sot, po merrni obligime të mëdha, po filloni shkollimin tuaj për të qenë të vlefshëm, kuptohet për vetën tuaj, por në radhë të parë, të vlefshëm për vendin dhe për qytetarët e vendit tonë. Kërkoj nga ju, që mos të na zhgënjeni as neve, as komandantët tuaj e as familjet tuaja. Ne jemi të bindur se i kemi zgjedhur më të mirët, sepse vetëm më të mirët munden me qenë oficerë të FSK-së".

Ministri Çeku, më pastaj, shtoi: "Ju po shkolloheni për të qenë të vlefshëm edhe për veten dhe familjen tuaj, por mbi të gjitha për të qenë të vlefshëm për vendin tonë, ju po merrni përgjegjësi të reja, po betoheni para ministrit, para prindërve, para komandantëve tuaj, që do të jeni të përkushtuar ndaj vendit."

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, jua ka rikujtuar kadetëve të rinj detyrat që duhet t'i kryejnë në të ardhme. "Që nga sot, ju përveç se jeni qytetarë, jeni në radhë të parë ushtarë dhe në çdo situatë, në çdo rrethanë duhet ta dini se kush jeni dhe si duhet të veproni, prandaj jeni ndryshe nga moshatarët tuaj, ju keni përzgjedh një profesion të vështirë i cili kërkon vetëmohim, përkushtim dhe guxim, por mbi të gjitha është një profesion shumë fisnik, ku nuk ka gjë më të mirë, se sa shërbimi për vendin dhe popullin tënd. Ju e kishit këtë fat, andaj mos harroni se në asnjë moment nuk duhet të dështoni, përkundrazi duhet të jeni shembull çdo kund; në kazermë, në universitet, në rrugë."

Në fund, kadetët e rinj të FSK-së, solemnisht, dhanë betimin para komandantit të Qendrës së Studimeve Universitare, kapiten Avni Kiçina.

Pas përfundimit të ceremonisë, familjarët së bashku me kadetët vizituan ambientet e QSU-së, ku u njoftuan me kushtet e kësaj qendre, në të cilën kadetët do të mësojnë dhe qëndrojnë për katër vjet gjatë studimeve.





Certifikohen 30 kadetë të FSK-së për "Menaxhimin e poligoneve të qitjes me armë"

Në ambientet (poligonin e gjuajtjes) e Komandës së Doktrinës dhe të Trajnimit (KDS) në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve të FSK-së, të cilët kanë kryer kursin (një trajnim) profesional për "Menaxhimin e poligoneve dhe të armëve" nga data 09-19 shtator 2013.

Kursi është realizuar nga instruktorë të Ushtrisë së Britanisë së Madhe (BMAT) dhe ka qenë kurs rezident, i realizuar gjatë natës dhe ditës.

Në ceremoni, morën pjesë ministri i FSK-së z. Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, instruktorë të Britanisë së Madhe, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së dhe KFOR-it.

Fillimisht, njësitet e FSK-së prezantuan praktikisht trajnimin për menaxhimin e poligonit me armë të gjata dhe të shkurta.

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, me këtë rast përgëzoi kadetët e FSK-së, për punën e madhe dhe për realizimin e këtij trajnimi me sukses për rritjen e kapaciteteve të aftësive të FSK-së. Ministri Çeku, falënderoi edhe instruktorët e Britanisë së Madhe, "të cilët kanë zhvilluar trajnime në FSK, edhe më parë, dhe kanë ndihmuar shumë që FSK-ja, t'i rrit kapacitetet e veta profesionale. Trajnimet që i zhvillojnë instruktorët nga Britania e Madhe, janë trajnime të veçanta, janë trajnime shumë kërkuese dhe pas çdo trajnimi, ne kemi dalë edhe më të fortë, edhe më të aftë, për t'i kryer detyrat tona". Ky trajnim është shumë i veçantë, "sepse ju po trajnoheni për përdorimin më të mirë të armëve dhe për të trajnuar njësitet e juaja, bartja e armëve, përdorimi i armëve është detyrë e çdo ushtari, është identitet i ushtarit, është ajo që na bënë të jemi ushtarë". Në fund ministri i FSK-së, Agim Çeku, nga kadetët kërkoi që t'i trajnojnë njësitet e veta në përdorimin sa më të efektshëm, sa më të mirë, sa më të sigurt të armëve, për të vazhduar: "Siguria në paqe, është numër një, besoj që këto aftësi t'i keni përvetësuar dhe do t'i zbatoni në njësitet e juaja. Ju tani jeni instruktorë të menaxhimit të poligoneve, instruktorë të gjuajtjeve me armë dhe duhet të jeni shembull për ushtarët e juaj. Këtu kërkohet disiplinë, kërkohet përkushtim, kërkohet respektim i procedurave standarde operative dhe besoj se këto i keni mësuar nga instruktorët e Britanisë së Madhe. Pra, ky trajnim është një fillim i ri, një trajnim i ri për FSK-në. Tani, juve ju takon t'i trajnoni njësitet e juaja. Ju jeni ata, që këtë detyrë të FSK-së do ta kryeni në mënyrë profesionale ashtu siç jeni trajnuar sot.

Ky trajnim ka pasur tri qëllime: trajnimin e oficerëve për menaxhimin e poligoneve, trajnimin e nënoficerëve senior dhe trajnimin e nënoficerëve junior, tha komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, për të shtuar, se: "Nënoficerët janë boshti kurrizor i çdo ushtrie, andaj edhe FSK i ka dhënë rëndësi të veçantë këtij trajnimi, që ne t'i trajnojnë nënoficerët për t'i përgatitur për misionet për kryerjen e detyrave për të ecën drejt realizimit të synimeve të veta, drejt objektivave për të profesionalizuar dhe për t'u përgatitur për të gjitha sfidat që kërkon e ardhmja. Ky është një trajnim që në të ardhmen si synim kryesor e ka pjesëmarrjen në operacione paqeruajtëse". Në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, falënderoi instruktorët e Britaninë së Madhe për kontributin e tyre në profesionalizimin e FSK-së.

Ndërsa, këshilltari i komandantit të FSK-së, nënkolonel Will SmallWood, në fjalën e tij, fillimisht përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për përfundimin me sukses të këtij trajnimi mjaft të rëndësishëm për FSK-në, dhe për të kërkuar nga kadetët e FSK-së, që njohuritë e fituara këtu, t'i bartin me sukses tek njësitet e tyre, si dhe kërkoi që përdorimi i armëve të zjarrit të jetë me standardet më të larta të mundshëm, shtoi në fund nënkoloneli SmallWood.

Në fund, ministri, komandanti dhe nënkoloneli Will SmallWood, ndanë certifikata për kadetët e trajnuar.





Komandanti i FSK-së dhe ambasadorja e SHBA-s, morën pjesë në ushtrimin e kërkim-shpëtimit

Në vendin e ashtuquajtur "Te Pishat", në fshatin Sllatinë e Madhe, Komuna e Fushë-Kosovës, u mbajt ushtrimi i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të FSK-së, në kërkim-shpëtim urban dhe ushtrimi i paramedikëve (teknikët medicinal ushtarak).

Skenari i ushtrimit të kërkim-shpëtimit, ishte kërkimi i një nxënëseje 6 vjeçe, e cila kishte humbur në malet e fshatit gjatë kthimit nga shkolla.

Për të përcjellë ushtrimin në kërkim-shpëtim urban dhe atë të paramedikëve kishin ardhur komandanti dhe zëvendës komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe gjeneralmajor Rrahman Rama, ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, zonja Tracey Ann Jacobson, atasheu ushtarak i SHBA-s, James Kott, zëvendësambasadori i Britanisë së Madhe Joe Preston, komandanti i BMO-së, kolonel Iljaz Dërguti, si dhe oficerë dhe ushtarë të FSK-së dhe KFOR-it.

Fillimisht, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, kolonel Shaip Haziri i njoftoi të pranishmit, për trajnimet dhe të arriturat e përgjithshme të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, i cili numëroi të arriturat e përgjithshme të Kompanisë së Mbrojtjes Kimike Atomike Biologjike - MKAB-së, të Kompanisë së Deminimit dhe të Task Forcës së kërkim-shpëtimit.

"Për momentin, ne po i mbajmë dy ushtrime; në kërkim-shpëtim urban me instruktorë amerikanë të iniciuar nga Ambasada e SHBA-ve, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit në mes SHBA-s dhe MFSK-së, dhe ushtrimin e paramedikëve me instruktorë anglezë, që të dy ushtrimet janë të një niveli shumë të avancuar. Instruktorët amerikanë dhe ata anglezë do të punojnë deri në fund të dhjetorit", njoftoi komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri.

Më pastaj, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe ambasadorja e SHBA-s, Tracey Ann Jacobson, në një terren të ashpër, arritën të lëshohen me litar për ta shpëtuar një qytetar të lënduar. Ambasadorja e SHBA-ve, Tracy Jacobson, me sukses u lëshua me litar edhe nga objekti i kazermës së RMC-së, në Pomozotin.

Me këtë rast, ambasadorja e SHBA-ve, Jacobson, falënderoi FSK-në dhe instruktorët amerikanë, për trajnimet e përbashkëta; për të shtuar se është kënaqësi e veçantë që po e përcjellë këtë ushtrim të kërkim-shpëtimit urban, të mbajtur nga instruktorët amerikanë dhe të FSK-së.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pasi ka falënderuar ambasadoren e SHBA-ve, Trecey Jacobson, për ndihmat e përgjithshme që po jep për FSK-në, ka përgëzuar Kompaninë e Kërkim-Shpëtimit urban, instruktorët amerikanë dhe ata anglezë, për trajnimet e përbashkëta që po i mbajnë me FSK-në. Ushtrimi i kërkim-shpëtimit urban i RMC-së, u vlerësua shumë i suksesshëm.







FSK-ja përuroi urën afër Manastirit të Deçanit


(Vijon nga faqja parë)

Në fund, ministri Çeku falënderoi komunitetin dhe KFOR-in, për angazhimin dhe bashkëpunimin e mirëfilltë.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati i përgëzoi pjesëtarët e Batalionit të Xhenios për realizimin, me sukses, të projektit të urës, të cilët siç tha ai, me këtë angazhim po kryejnë punë të shkëlqyeshme në dobi të gjitha komuniteteve.

Nga ana e tij, i pari i Manastirit të Deçanit, Sava Janjiçi, në emër të kishës falënderoi ministrin Çeku dhe FSK-në, për punën e shkëlqyeshme dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të mira me komunitetin e tij dhe gjithashtu falënderoi edhe KFOR-in, për angazhim rreth realizimit të këtij projekti.

Projekti i ndërtimit të urës është realizuar nga Batalioni i Xhenios së FSK-së, me kërkesë të Komunës dhe të komunitetit të Deçanit, për shkak të vështirësive dhe pamundësisë për qarkullim të lirë mbi Lumbardhë, si pasojë e dëmtimit të urës së vjetër. Ura e re, të cilën e ka ndërtuara FSK-ja është prej materiali të fortë metalike, ka gjatësinë prej 38 metrave dhe gjerësi 1.5 metra. Realizimi i këtij projekti është kryer në afat prej 15 ditëve.



Përveç urës në Deçan, FSK-ja gjatë muajit qershor ka ndërtuar edhe urën montazh në Kramovik, mbi lumin Drini i Bardhë, përkatësisht në aksin që lidhë komunën e Gjakovës dhe Klinës. Të dyja këto projekte janë realizuar në një afat rekord dhe janë vënë në funksion të qarkullimit për qytetarët e dhe automjete të këtyre lokaliteteve dhe në përgjithësi për të gjithë qytetarët e vendit. Ndërsa, në fshatin Plemetin, FSK-ja ka hapur shtratin e lumit.

Ministri dhe Komandanti i FSK-së morën pjesë në stërvitjen "LUANI SHQIPTAR 2013"



Ministri i FSK-së Agim Çeku së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, morën pjesë (në ditën e personave shumë të rëndësishëm) në ushtrimin "LUANI SHQIPTAR 2013" (Albanian Lion 2013), Ushtrim ky i përbashkët i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Britanisë së Madhe.

Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ishin mysafirë nderi dhe njëherësh e përcollën nga afër, ushtrimin e koduar "Luani shqiptar 2013".

Ushtrimi "Luani shqiptar 2013" u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dypalësh midis FA të Shqipërisë dhe FA të Mbretërisë së Bashkuar. Për të përcjellë ushtrimin e përbashkët morën pjesë personalitet më të larta të Shqipërisë, Britanisë së Madhe dhe të rajonit.

Për të pranishmit në këtë aktivitet u zhvillua një demonstrim i përbashkët i Forcave Ajrore të Britanisë së Madhe dhe Forcave Ajrore të Shqipërisë.

Stërvitja e përbashkët "Luani shqiptar 2013", është një stërvitje shumë skenarësh, me pjesëmarrje të rreth 3000 trupave britanike, kryesisht komando dhe forca detare.

Stërvitja e përbashkët shqiptaro-britanike "Luani shqiptar 2013" ka një shtrirje të gjerë gjeografike, duke filluar prej rajonit stërvitor të Bizës, në Pashaliman, Kuçovë, Karaburun dhe Sazan. Forcat e Armatosura janë angazhuar në stërvitje me trupa dhe mjete të Forcës Detare, si dhe trupa të Forcës Tokësore në realizimin e skenarëve të përbashkët.

Stërvitja e përbashkët "Luani shqiptar 2013"përfshiu në vetvete tri stërvitje, secila me një skenar të caktuar. Gjatë periudhës njëmujore të qëndrimit, trupat britanike realizuan dhe kryen veprime ushtarake në det dhe në tokë, në operacione të evakuimit, zbarkimit detar, qitje, etj.



Komandanti i FSK-së dekoron me medalje kolonelin turk Sefer Acar

Me rastin e përfundimit të mandatit të kolonelit Sefer Acar, oficer i KFOR-it Turk, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati e ka dekoruar me medalje me motivacionin për angazhimin e shkëlqyeshme që ka treguar gjatë kryerjes së detyrës së këshilltarit ushtarak në Kabinetin e Komandantit të FSK-së, dhe për shërbim meritor në FSK. Komandanti i FSK-së, gjeneral Kadri Kastrati, falënderoi ushtrinë e Turqisë për ndihmën e vazhdueshme që po jep për FSK-në.



Me këtë rast edhe ministri Çeku falënderoi kolonelin Sefer Acar dhe ushtrinë e Turqisë, për ndihmën e pakursyer dhe për angazhimin e oficerëve turq, në kuadër të këshilltarëve të NAT-it (Ekipit Këshillues të NATO-s).

Ministri Çeku, duke iu drejtuar kolonelit Acar, tha: "Ju keni punuar shumë dhe keni qenë i gatshëm për të ndarë dijen dhe përvojën me stafin tonë, ku të gjithë kanë përfituar shumë nga këshillat tuaja".

Intervistë me pjesëtaren e FSK-së të komunitetit serb Nalan Bajrami

Toger Nalan Bajrami: oficere e suksesshme dhe nënë e përkushtuar



Toger Nalan Bajrami është e sistemuar në Batalionin e Xhenios (BXH), në kuadër të Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) në kazermën e FSK-së "Adem Jashari" në Prishtinë. Ajo është udhëheqëse e togut të administratës dhe specialistëve të skuadrës së komunikimit në këtë batalion. Ka 11 pjesëtarë nën komandën e saj, për të cilët thotë se çdo detyrë që u delegohet atyre ata e bëjnë me shumë përgjegjësi dhe precizitet". Ajo ka qenë edhe pjesëtare e ish-TMK-së dhe është prej të parëve që është pranuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Nalan ka përfunduar shkollën e mesme ekonomike në gjuhën shqipe, në Prishtinë, andaj e flet shumë mirë gjuhën shqipe. Toger Nalani, Batalionin e Xhenios e cilëson si shumë të rëndësishëm, sepse pjesëtarët e këtij batalioni marrin pjesë në shumë projekte humanitare që kanë të bëjnë më popullatën. "Jam shumë e kënaqur me punën që bëjë dhe e ndjehem e lumtur për ndihmën qe ua ofroj njerëzve që kanë nevojë për ndihmën time" u shpreh toger Bajrami. Se cila ka qenë arsyeja kryesore që i është bashkuar FSK-së, ajo shprehet: "Dashuria dhe dëshira për të veshur uniformën dhe për ta mbrojtur vendin, janë ato që më japin energji, pasi gjatë luftës nuk kam qenë në Kosovë dhe nuk kam mundur t'i bashkohem uniformës" tha Nalani. Ajo është nënë e 4 fëmijëve dhe thotë që fëmijët e saj mburren që ajo është pjesë e FSK-së dhe janë krenar me FSK-në." Edhe fëmijët shpeshherë dëshirojnë t'i bashkohen FSK-së" shton Nalani. Toger Nalan Bajrami është pjesëtare e komunitetit serb, babin e ka të komunitet turk, nënën të komunitetit serb dhe bashkëshortin e ka shqiptar. "Familja jonë feston të gjitha festat, festojmë Bajramin, po ashtu edhe Krishtlindjet" tha ajo. Toger Nalani e përshkruan ditën e saj si shume të zënë pasi që përveç punës që bënë në FSK, ajo është e angazhuar edhe në shtëpi me familjen e saj dhe nuk dëshiron që asnjëherë t'i lërë anash ose t'u mungojë diçka fëmijëve të saj. "Unë e kam të ndarë punën dhe familjen dhe problemet e punës i ndaj nga ato të familjes" përfundoi Nalan Bajrami.

Ambasadori Kallaba vizitoi togun e FSK-së në Bullgari

Ambasadori i Republikës së Kosovës në Bullgari, z. Shpend Kallaba, vizitoi togun e MKABL-së të FSK-së, ku në Qendrën Profesionale të Trajnimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Bullgarisë, në Montana, po qëndrojnë për një trajnim profesional, 6 javor, për "Lëndë të Rrezikshme", organizuar nga Grupi për Mbrojtje Civile, pranë Komitetit për Planifikim Civil Emergjent të NATO-s.

Ambasadori Kallaba së bashku me komandantin e togut të MKAB-së, kapter Abedin Kiqina, u pritën nga kryetari i Komunës së Montanës, z. Zlatko Zivkov, i cili, pasi iu uroj mirëseardhje shprehi gatishmërinë e tij, që të jetë në dispozicion të Togut të FSK-së, gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tyre në qytetin Montana.

Ambasadori Kallaba falënderoi kryetarin e komunës, z. Zhivkov si dhe Qeverinë e Bullgarisë, për ndihmën që po japin për popullin e Kosovës dhe në veçanti për FSK-në. Njëherësh, ai u shprehu mirënjohje autoriteteve bullgare për trajnimin e togut të FSK-së, si dhe përsëriti gatishmërinë e Kosovës që të dinamizojë relacionet me Bullgarinë në fushën e sigurisë.



Intervistë me drejtoreshën e Departamentit Ligjor të MFSK-së, zonjën Krenare Sogojeva-Dermaku

Arritjet e Departamentit Ligjor të MFSK-së janë rezultat i punës ekipore

Gazeta" Forca Jonë": *Në kuadër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, (MFSK), Departamenti Ligjor dallohet për suksese. A mund të na tregoni si e arrini këtë, zonja drejtoreshë?*

Krenare Sogojeva-Dermaku: Departamenti Ligjor, si njësi organizative, është në vartësi të Sekretarit të Përgjithshëm të MFSK-së, në kuadër të kompetencave të dhëna me legjislacionin në fuqi, ka për fushëveprim kryesisht hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar që ndërlidhen me MFSK-në dhe FSK-në, ofrimin e këshillave dhe propozimeve ligjore për zinxhirin komandues të MFSK-së dhe FSK-së, mbi të gjitha çështjet që kanë implikime ligjore duke kontribuar njëherësh me këshilla ligjore dhe mbështetje për Komisione, Borde, Panele dhe Grupe Punuese, relevante përbrenda MFSK-së, FSK-së dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke mos harruar këtu edhe rolin e këtij departamenti në kryerjen e negociatave dhe mbikëqyrjen e marrëveshjeve të dyanshme dhe të shumanshme si të nivelit vendor po ashtu edhe atë të nivelit ndërkombëtar. Suksesi i Depatamenit Ligjor është rezultat i përkushtimit dhe punës kolegjiale të të gjithë zyrtarëve të departamentit, mbështetjes nga instancat e larta të vetë institucionit, duke synuar hartimin e legjislacionit më të mirë sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare, monitorimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni, me qëllim të përmbushjes dhe avancimit të misionit kushtetues të FSK-së, si një ndër mekanizmat më të rëndësishëm të Sektorit të Sigurisë në Republikën e Kosovës. Po ashtu, bashkëpunimi i mirëfilltë me departamentet dhe njësitë e MFSK-së dhe FSK-së, me këshilltarët e Ekipit Këshillues të NATO-s, si dhe gatishmëria e ofrimit të këshillave ligjore në kohë është një element tjetër që ka treguar hapat e suksesit në përmbushjen e detyrave të departamentit. Arsimimi i vazhdueshëm qoftë përmes trajnimeve apo edhe specializimeve të veçanta të personelit, është një indikator tjetër i qëndrueshëm që departamenti të jetë profesional.



Gazeta "Forca Jonë": *Cilat nga të arriturat konkrete të Departamentit Ligjor mund t`i veçoni?*

Krenare Sogojeva Dermaku: Përgjithsisht, Departamenti Ligjor aktivitetet e veta i organizon mbi bazën e Planit të Aprovuar të Veprimit të këtij Departamenti, të hartuar paraprakisht për çdo vit kalendarik, duke renditur sipas prioriteteve nga fushëveprimtaria e tij. Departamenti Ligjor ka arritur që në mënyrë të plotë dhe brenda afateve të parapara të përmbushë të gjitha aktivitetet sipas planit të veprimit. Kësisoj, të arriturat e Departamentit Ligjor, janë evidente në të gjitha sferat e aktiviteteve tona. Korniza ligjore aktuale që rregullon shërbimin në FSK, në veçanti hartimi i legjislacionit që rregullon pensionimin e pjesëtarëve të FSK-së, krijimi i infrastrukturës ligjore për dërgimin e pjesëtarëve të FSK-së, në operacione jashtë vendit, janë rezultat i punës së vazhdueshme dhe bashkëpunuese të Departamentit Ligjor. Aktivitet në kontinuitet mbetet negocimi (shkrimi ligjor) për marrëveshjet bilaterale dhe ndërkombëtare, ku vlen të theksohet Marrëveshja për Statusin e Forcave me Republikën e Shqipërisë, që mundëson lëvizjen legale të trupave ushtarake dhe pajisjeve në territoret, respektive, marrëveshjet ndërkombëtare me Republikën e Turqisë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermaninë, Slloveninë si dhe marrëveshjet që rregullojnë statusin e përfaqësuesve diplomatik ushtarak. Me qëllim të njoftimit për të drejtat dhe obligimet e pjesëtarëve të FSK-së, Departamenti Ligjor në bashkëpunim me këshilltarët ligjor të KFT-së, ka mbajtur trajnime nëpër të gjitha kazermat e FSK-së. Përfaqësimi i Ministrisë së FSK-së, në seminarin për ngritjen e infrastrukturës ligjore për Obuspersonin e forcave të armatosura, të organizuar nga DICAF dhe GIZ në Vjenë të Austrisë, pastaj prezantimi i krijimit të bazës ligjore për shtetin e ri të Kosovës në Konferencën Ligjore të Komandës Ushtarake Amerikane në Evropë, faktor që tregojnë besueshmërinë dhe potencialin profesional të Departamentit.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili në të vërtetë është personi, që e udhëheq Departamentin Ligjor?*

Krenare Sogojeva Dermaku: Që nga fundi i vitit 2008 e udhëhoqi Departamentin Ligjor në MFSK. Kam kryer Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Prishtinës, si dhe kam kryer edhe studimet post-diplomike në Kolegjin Evropian të Parmës, në Itali. Që nga viti 2005 kam punuar në Zyrën Ligjore të Kryeministrit, fillimisht si praktikante e pastaj si zyrtare e lartë ligjore, si dhe kam qenë koordinatore e Tryezës Legjislative në Sekretariatin e Qeverisë, deri në transefimin e saj në MFSK. Gjatë vitit akademik 2010/2011 kam qenë ligjëruese e lëndës "Kompetencat ndërkulturore" në Universitetin e Prizrenit. Paraprakisht, kam punuar në shumë OJQ vendore dhe ndërkombëtare, si në Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut. Nga viti 2000 deri 2003 kam punuar për Sektorin për Siguri dhe Sektorin e Trajnimeve në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në Prishtinë.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janë planet e ardhshme të Departamentit Ligjorë?*

Krenare Sogojeva Dermaku: Planet dhe prioritetet e Departamentit Ligjor të MFSK-së janë në harmoni dhe në relacion me prioritetet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, respektivisht, at, sa i përket hartimit të legjislacionit përkatës për programin legjislativ dhe planin e veprimit të paraparë për vitin në vijim, si dhe në relacion me rishikimin e legjislacionit ekzistues si rrjedhojë e miratimit të nismës për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës të Kosovës (RSSS). Si një aktivitet me rëndësi të veçantë, mbetet përfundimi i procesit të rishikimit të Sektorit të Sigurisë, konkretisht sa i përket aspektit legjislativ të ndryshimit të kuadrit ligjor, në bazë të rekomandimeve të RSSS-së, si një ndër qëllimet e miratimit të këtij rishikimi, me çka do të inicioheshin të gjitha procedurat relevante për ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues për të ngritur FSK-në në një forcë me të gjitha kapacitetet e nevojshme (ushtarake) në mbrojtjen dhe sigurinë e vendit tonë dhe qytetarëve të saj.

Gazeta "Forca Jonë": *Çka e dallon Departamentin Ligjor të MFSK-së nga departamentet ligjore të ministrive tjera?*

Krenare Sogojeva Dermaku: Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë, si institucione të reja janë themeluar me Ligjin për Ministrinë e FSK-së, Ligjin për FSK-në dhe Ligjin për Shërbim në FSK, si kërkesë e propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës (Plani i Ahtisarit). Ministria e FSK-së dhe FSK kanë filluar funksionimin mbi bazën e këtyre tri ligjeve të miratuar në Pakon e ligjeve të ashtuquajtur "Pakoja e Ahtisatit". E gjithë infrastruktura tjetër ligjore e MFSK-së dhe FSK-së (ligjet dhe mbi 70 akte nënligjore) është hartuar nga Departamenti Ligjor, që nga viti 2008. Krijimi dhe hartimi i legjislacionit ka filluar nga e para për një sferë të ndjeshme dhe delikate siç është siguria, në këtë rast Forca e Sigurisë, ka qenë sfidë njëkohësisht edhe sukses që është arritur me përgjegjësi të plotë për një kohë relativisht të shkurtë. Vënia e kornizave ligjore dhe zhvillimi i vazhdueshëm i legjislacionit rregullon sot të gjitha fushat e veprimit të MFSK-së dhe FSK-së, në kuadër të misionit dhe kompetencave të dhëna me Kushtetutë dhe Ligj. Vetë struktura e kombinuar e Departamentit, me nëpunës civil dhe ushtarak, ka bërë që Departamenti të kompletohet në ushtrimin e funksioneve të tij, me njohuritë si në sferën e përgjithshme juridike po ashtu edhe në atë ushtarake.

Gazeta "Forca Jonë": *Mesazhi juaj?*

Krenare Sogojeva Dermaku: Padyshim, profesionalizimi është hapi më qenësor për suksese, mirëpo themeli deri tek ngjyrosja e suksesit është përkushtimi ndaj punës dhe gatishmëria në përgjigje të kërkesave për këshillim ligjor, e mbi të gjitha puna ekipore, si akt për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.



Certifikohen 33 oficerë dhe zyrtarë të CIMIC në MFSK-FSK



Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcës Tokësore(KFT) në Prishtinë, u organizua ceremonia e certifikimit të zyrtarëve dhe oficerëve të Departamentit për Bashkëpunim Civil-Ushtarak të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe të FSK-së (FSK).

Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë: komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i Komandës së Forcës Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralbrigade Imri Ilazi, drejtor i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve, Haxhi Shala, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane, atasheu ushtarak i SHBA-s, në Prishtinë, koloneli James Kott, zyrtarë të KFOR-it, të NAT-it dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Ky trajnim është organizuar nga Departamenti për Bashkëpunim Civil-Ushtarak i MFSK-së, në bashkëpunim me Ambasadën e Amerikës në Prishtinë, këshilltarët e NAT-it dhe është realizuar nga instruktorët e ushtrisë amerikane dhe asaj të ushtrisë suedeze.



Në fjalën e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pasi përshëndeti dhe falënderoi instruktorët amerikanë dhe ata suedezë, potencoi se prioriteti numër një, për Të, është profesionalizimi i FSK-së. Ndërsa, për CIMIC-un tha: kanë realizuar shumë projekte të rëndësishme në interes të qytetarëve, por zhvillimi dhe profesionalizimi i CIMIC, është më rëndësi të madhe, për realizimin e shumë projekteve-operacioneve, qoftë ato që zhvillohen-realizohen brenda ose jashtë vendit.

Për këtë, çelësi kryesor për çdo operacion ose projekt, është vetëm një CIMIC, i zhvilluar në aspektin profesional.

Komandanti i FSK-së, nga instruktorët amerikanë dhe ata suedezë, kërkoi vazhdimin e trajnimeve më të avancuar, në aspektin profesional, për CIMIC-un.

Trajnimi ka filluar, më 16 shtator dhe ka përfunduar, më 20 shtator 2013, ku kanë marrë pjesë 33 zyrtarë dhe oficerë të MFSK-së dhe FSK-së. Gjatë trajnimit janë realizuar shumë tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin e BCU-së, në nivel faktorial, operacional dhe strategjik.

Ndërsa, drejtori i Departamentit të BCU-së, z. Hajrush Kurtaj, i njoftoi të pranishmit për rëndësinë e trajnimit si dhe arritjen e qëllimit të trajnimit, në aspektin profesional, me çka falënderoi instruktorët e SHBA-s dhe ata të Suedisë.

Gjatë trajnimit një javor janë realizuar tema të shumta me interes të veçantë për CIMIC-un, siç, janë: Hyrje në trajnim, Njohuritë e përgjithshme për BCU-në, Detyrat dhe Misioni i BCU-së, Funksionimi, Struktura, Misioni dhe Detyrat, Qendra e BCU-së, Struktura qëllimet dhe kontestet, Qendrat e BCU-së, Moduli i BCU-së, Plani - Projektet, Negociatat dhe ndërmjetësimi, PSO e BCU-së, në një kontest, Matja e efektit dhe matja e progresit.

Trajnimi ishte i niveli të lartë profesional, ku interesimi i zyrtarëve dhe pjesëtarëve të MFSK-së dhe FSK-së ishte i madh.

Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me atasheun ushtarak të SHBA-ve në Prishtinë, kolonelin James Kott dhe këshilltarin e NAT-it në MFSK, nënkolonel Kristian Boving, ju dhanë certifikata zyrtarëve dhe pjesëtarëve të MFSK-së dhe FSK-së.

Një tog i MKABK-së trajnohet në Bullgari



Një tog i Kompanisë së Mbrojtjes Kimiko-Atomike dhe Biologjike (MKAB) të Forcës së Sigurisë së Kosovës, (FSK) në përbërje prej 20 pjesëtarëve, u nisë për një trajnim gjashtëjavësh, në Qendrën Profesionale të Trajnimit të Drejtorisë së Përgjithshme pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në qytetin Montana të Republikës së Bullgarisë. Trajnimi i Forcave të Sigurisë së Kosovës, në këtë kurs "Lëndë të rrezikshme" organizohet me ndihmën e Grupit për Mbrojtje Civile, pranë Komitetit për Planifikim Civil Emergjent të NATO-s. Trajnimi do të mbahet në Qendrën Profesionale të trajnimit të Drejtorisë së Përgjithshme "Siguria kundër zjarrit dhe mbrojtja e popullsisë" pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Bullgarisë. Trajnimi është i destinuar për ata që reagojnë të parët në raste të aksidenteve me lëndë të rrezikshme. Qëllimi i trajnimit është që pjesëmarrësit në trajnim të përfitojnë dije dhe njohuri praktike për kryerjen e veprimtarive për pakësim të pasojave në raste aksidentesh me lëndë të rrezikshme.

Trajnimi do të zhvillohet nën formën e dijeve teorike, përmes ligjëratave, seminareve dhe ushtrimeve në grupe, dhe mësimeve praktike; në Kompleksin e Trajnimit të Qendrës. Në përcjellje të togut të MKAB-së, për Bullgari, kishte dal edhe komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri i cili, me këtë rast iu tha: "Unë besoj se ju do ta kryeni trajnimin si dini më së miri, dhe do të ktheheni me rezultate të shkëlqyeshme. Ky trajnim ka rëndësi të madhe për ju dhe FSK-në, sepse po mbahet në një Qendër të një niveli të lartë profesional. Në fund kolonel Haziri kërkoi nga togu i MKAB-së, disiplinë, përkushtim dhe profesionalizëm". Trajnimi do të përfundojë pas gjashtë javësh.

Diplomojnë pjesëtarët e Brigadës për Reagim të Shpejtë



Pas një trajnimi katër mujorë të pjesëtarëve të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) të FSK-së në Istog, Mitrovicë dhe Gjilan, janë organizuar ceremoni diplomimi, më datë: 09 dhe 11 shtator 2013.

Më 9 shtator është organizua ceremonia e diplomimit në Batalionin e Parë të BRSH-së në Gjilan, ku janë certifikuar 28 pjesëtarë të togut të Kompanisë së Parë, 1A, për Reagim të Shpejtë, ndërsa, më 11.09.2013 , janë certifikuar edhe 81 pjesëtarë të Kompanisë të Dytë, 2A, të Batalionit të Dytë të BRSH-së në Istog dhe 87 pjesëtarë të Kompanisë së Tretë B, të Batalionit të Tretë për Reagim të Shpejtë në Mitrovicë.

Trajnimet e pjesëtarëve të BRSH-së kanë filluar në muajin maj të vitit 2013, ku për katër muaj rresht pjesëmarrësit janë trajnuar nga ekipet KFOR-it turk.

Trajnimi kishte për qëllim ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së në këto fusha: navigim tokësor, trajnime taktike, sigurim i bazës dhe konvojeve, pika kontrolli etj.

Në ceremonitë e zhvilluara, komandantët e tri batalioneve: major Haki Xhemejli (komandant i Batalionit të Parë në Gjilan), major Valdet Berisha (zëvendës komandant i Batalionit të Dytë, Istog) dhe nënkolonel Arsim Shaqiri (komandant i Batalionit të Tretë, Mitrovicë), vlerësuan lartë angazhimin e pjesëtarëve të BRSH-së, për të përfituar sa më shumë njohuri profesionale, gjatë katër muajve të trajnimit nga instruktorët e ekipeve trajnuese të KFOR-it turk.

Në fund, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, ndau mirënjohje për të gjithë instruktorët e KFOR-it turk, për angazhimin e tyre maksimal dhe për kontributin e dhënë gjatë trajnimit të pjesëtarëve të BRSH-së.

FSK-ja mban Ushtrimin Fushor "Shqiponja 2"



Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) në fillim të muajit tetor, do të mbaj Ushtrimin Fushor të koduar ,,Shqiponja 2", i cili do të realizohet në disa rajone të Kosovës. Për këtë qëllim FSK-ja ka bërë të gjitha përgatitjet dhe marrëveshjet paraprake me komunat dhe të gjitha institucionet që do të jenë pjesë e këtij ushtrimi, me qëllim që mbarvjatja e ushtrimit të zhvillohet sipas planifikimeve.

Qëllimi i FSK-së është që përmes ushtrimit fushor "Shqiponja 2" të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të Njësive, të Shtabeve dhe të pjesëtarëve në terren.

Konvojet e Forcës së Sigurisë së Kosovës do të marshojnë nga vendbanimet e tyre; Prishtina, Ferizaj, Gjilani, Mitrovica dhe Pomozotini, për në rajonet e grumbullimit, dhe kryesisht aktiviteti i ushtrimit do të jetë i përqendruar në territorin e komunave; Pejë, Istog, Prizren dhe Klinë.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës njoftojnë opinionin e gjerë dhe të gjithë qytetarët; se lëvizjet e kolonave të automjeteve të FSK-së, do të bëhen me qëllim të realizimit të ushtrimit. Pra, dislokimi i njësive dhe lëvizja e kolonave në rrugët magjistrale dhe lokale do të vërehen gjatë 10 ditëve të para të tetorit dhe atë gjatë 24 orëve, deri me përfundimin e ushtrimit fushor "Shqiponja 2".

FORCA JONË

* * * Viti II • Nr. 18 • Nëntor 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Është mbajtur ushtrimi fushor "Shqiponja -2"

FSK-ja demonstroi nivel të lartë të mobilizimit, përkushtimit dhe profesionalizmit

Qëllimi i mbajtjes së ushtrimit fushor "Shqiponja 2" ishte që të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të njësive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren.



Për të përcjellë ushtrimin e FSK-së në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog , morën pjesë: presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, zëvendësministrat e FSK-së; Muhamet Latifi e Bejtush Gashi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët e FSK-së dhe stafi më i lartë i Ministrisë dhe FSK-së, përfaqësues të KFOR-it, shefi i Ekipit Ndërlidhës dhe Këshillues i NATO-s, gjeneral Norbert Vagner, atashe ushtarak të akredituar në Prishtinë dhe oficerë të lartë të FSK-së, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Fillimisht, presidentja Jahjaga është pritur në kazermën "Ushtarët e NATO-së" në Istog nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Më pas, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, kolonel Naim Haziri, e njoftoi Presidenten dhe mysafirët e lartë me skenarin dhe objektivat e ushtrimit fushor "Shqiponja 2".

Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, përcolli ushtrimin në disa pika, si: Intervenimin e pjesëtarëve të Mbrojtjes Kimiko-Atomike Biologjike (MKAB)), të kërkim-shpëtimit, deminimit dhe të mbrojtja e konvojit. Me këtë rast, presidentja e Kosovës, zonja Jahjaga i përgëzoi drejtuesit e FSK-së, oficerët dhe ushtarët për angazhimin e tyre në realizimin e ushtrimit fushor "Shqiponja 2". Në fjalën saj, presidentja Jahjaga, ndër të tjera, tha: "FSK-ja dha një dëshmi të qartë për nivelin e profesionalizmit dhe të përgatitjes profesionale që ka arritur deri tash. Në veçanti falënderoj Gardën Kombëtare të Ajovës, pjesëtarët e Ushtrisë amerikane dhe pjesëtarët e KFOR-it, të cilët kanë ndihmuar dhe po ndihmojnë në mënyrë të vazhdueshme avancimin dhe përgatitjen profesionale të FSK-së".

Në emër të Ministrisë së FSK-së, të pranishmit i përshëndeti zëvendësministri Muhamet Latifi, i cili falënderoi pjesëtarët e FSK-së, të KFOR-it dhe të Ushtrisë amerikane, për realizimin me sukses të ushtrimit fushor "Shqiponja 2". Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në fjalën e tij përshëndeti pjesëtarët e FSK-së, për realizimin e këtij ushtrimi gjithëpërfshirës, KFOR-in, për ndihmën profesionale dhe sidomos Ushtrinë amerikane dhe Gardën Kombëtare të Ajovës.

Gjeneral Kastrati, me këtë rast tha: "Stërvitja e pjesëtarëve dhe e njësive të FSK-së, është objektiv dhe prioritet kyç i imi dhe i komandantëve në të gjitha nivelet. Ushtrimi fushor ,,Shqiponja 2" është finalizim i suksesshëm i ciklit të stërvitjeve individuale dhe kolektive të FSK-së, për këtë vit. FSK-ja realizimin e ushtrimit fushor e ka filluar më 3 tetor dhe ka vazhduar pandërprerë për 8 ditë me radhë, ku janë angazhuar 1951 pjesëtarë me 161 automjete. Ushtrimi u zhvillua në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës, kryesisht në Regjionin e Pejës dhe Prizrenit.

Qëllimi i ushtrimit fushor "Shqiponja 2" ishte që të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të njësive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren.

Komandant Kastrati përgëzoi veçanërisht ushtarët, nënoficerët dhe oficerët të cilët treguan profesionalizëm, vullnet dhe disiplinë për të realizuar të gjitha objektivat e parashikuara të ushtrimit.

Suedia mbështet FSK-në dhe Kosovën



Zëvendësministri i FSK-së, z. Muhamet Latifi së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin, kanë pritë, në një takim zyrtar, ministren e Mbrojtjes të Suedisë, zonjën Karin Enstrom me bashkëpunëtorë. Ministrja e Mbrojtjes së Suedisë u prit me nderimet më të larta nga Njësia Ceremoniale dhe Orkestra Frymore e FSK-së.

Fillimisht, zëvendësministri Latifi dhe ministrja Enstrom biseduan kokë më kokë, për të vazhduar më pastaj takimin e përbashkët në mes të dy delegacioneve.

Zëvendësministri i FSK-së, Muhamet Latifi, e falënderoj Qeverinë e Suedisë dhe personalisht Ministren Karin Enstrom, për ndihmën e veçantë dhe të vazhdueshme që kanë dhënë dhe po japin për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Suedia është një nga vendet që ka kontribuar shumë për FSK-në.

Zëvendësministri Muhamet Latifi, për të pranishmit u shpreh se ky takim kishte karakter pune, ku e informova ministren Enstrom me zhvillimin e përgjithshëm të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, me objektivat e Ministrisë, me progresin e arritur, bashkëpunimin si dhe procesin e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë. Në fund, ai tha se janë akorduar me ministren e Suedisë që të konkretizohen fushat specifike të bashkëpunimit dhe të nënshkruajnë së bashku

një memorandum mirëkuptimi.

Ministrja e Mbrojtjes së Suedisë, zonja Karin Enstrom, u shpreh:"Për mua është kënaqësi e veçantë që jam për vizitë në Prishtinë dhe në FSK. Ne biseduam me zëvendësministrin dhe komandantin e FSK-së, për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Për ne është në interes ta mbështesim Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kosovën në tërësi në mënyra të ndryshme. Ne, kemi diskutuar se si të gjejmë mënyra të bashkëpunimit për ta ndihmuar Qendrën Ekselence të Kërkim-Shpëtimit dhe gjithashtu kemi biseduar edhe për projekte tjera të përbashkëta", ka thënë,znj.Enstrom

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati e njoftoi ministren e Mbrojtjes së Suedisë, znj. Karin Enstrom dhe delegacionin e Suedisë, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së; plotësimin e kapaciteteve të përgjithshme operacionale, shkollimin, trajnimet, bashkëpunimin e mirë që kanë me shtetet rajonale si dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e veçanërisht me Gardën Kombëtare të Ajovës, e njoftoi për pjesëmarrjen e FSK-së, në trajnimet rajonale, për operacionet e kryera nga Kompania e Deminimit, Kërkim-Shpëtimit, si dhe projektet humanitare dhe për projektet e planifikuara për të ardhmen.

Gjeneral Kastrati, edhe kësaj radhe, kërkoi ndihmën e Armatës së Suedisë (me mjete të rënda-ekskavator kundër minave) për pastrimin edhe të tri objekteve të minuara dhe të shkatërruara gjatë luftës, siç janë; Kazerma "Adem Jashari" në Prishtinë, në Llukar dhe afër Aeroportit të Prishtinës, në Sllatinë.

Gjeneralmajor Rama: "Shqiponja 2", ishte sfidues i të gjitha njësive të FSK-së në terren



Zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralmajor Rrahman Rama, njëherësh komandant i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), për ushtrimin fushor "Shqiponja 2" tha: Niveli i gatishmërisë së pjesëtarëve të FSK-së, gjatë mbajtjes së ushtrimit fushor "Shqiponja 2", ishte i lartë, ndërsa angazhimi dhe disiplina ishin në nivelin e duhur. Kjo ka bërë që pjesëtarët e njësiteve të specializuara të përshtaten plotësisht me rrethanat e reja që janë krijuar gjatë ushtrimit në terren. Për ne me rëndësi ka qenë procesi i vendimmarrjes, i cili është realizuar me sukses sipas skenarit paraprak. Po ashtu është arritur edhe qëllimi im që të sfidohen të gjitha njësitet, duke i spikatur kështu anët e tyre të forta dhe duke i identifikuar dobësitë që duhet të përmirësohen, si: shkathtësitë individuale, kolektive dhe mbështetjen e nevojshme për operim. Ky qëllim është arritur, por tani fillon puna kryesore; "Këto mësime të mësuara duhet të inkorporohen në plan dhe të eliminohen mangësitë që kemi pasur si dhe të mirëmbajmë ato shkathtësi me të cilat qëndrojmë mirë.

Gjatë ushtrimit fushor "Shqiponja 2" treguam se kemi kapacitete dhe aftësi për përmbushjen e misionit që kemi dhe se jemi të gatshëm për misione të tjera në të ardhshmen.

Megjithatë, nuk duhet të vetëkënaqemi por të vazhdojmë të punojmë që në të ardhmen të jemi më të përgatitur në planet rezervë. Komanda e Forcave Tokësore (KFT) duhet të jetë gjithmonë një hap përpara, si në përcjelljen e operacioneve ashtu edhe në reagimin e kërkesave që vijnë nga poshtë.

Vitin e ardhshëm, një periudhë kohore duhet ta rezervojmë për trajnime të përbashkëta në mes të gjitha njësive të FSK-së, në mënyrë që të arrihet bashkëveprimi dhe ndërveprimi në mes njësive".

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati ka takuar Nexhdet Ozelin, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë

Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë vazhdojnë ta përkrahin FSK-në

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti në takim në Ministrinë e Forcës së Sigurisë gjeneralin me katër yje Nexhdet Ozel (Necdet Ozel), shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati e njoftoj shefin e Ushtrisë së Turqisë mbi ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së për këtë periudhë pesëvjeçare; e njoftoj mbi strukturën, detyrat e FSK-së, si edhe objektivat e saj për të ardhmen. Gjeneral Kastrati tha se FSK-ja ndër të tjera është duke kryer suksesshëm operacione të deminimit, operacione humanitare në dobi të gjithë qytetarëve të Kosovës, gjithashtu FSK-ja në vazhdimësi është duke asistuar në ndihmë mjekësore popullatën në zonat rurale ku jetojnë pjesëtarë të komuniteteve. Komandanti i FSK-së, gjithashtu para gjenerali Ozel shpalosi edhe objektivat e Ministrisë dhe Forcës, Ai tha se qëllimi ynë është që FSK-ja të ngrihet profesionalisht edhe në nivel më të lartë, të jetë e disiplinuar, shumetnike dhe e dislokueshme. Kosova, shtoi më tej gjeneral Kastrati, është në proces të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe me këtë edhe të FSK-së . Synojmë që FSK-në ta bëjmë një Forcë e cila do t'ju përgjigjet nevojave të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj, si edhe ta bëjmë një institucion me mision adekuat, që do të jetë Forcë për të mirë në rajon dhe partnere e denjë e NATO-s dhe shteteve anëtare të saj.

Gjeneral Kastrati, gjithashtu në kuadër të bashkëpunimeve bilaterale që ka Ministria e FSK-së me shumë shtete, u ndal te bashkëpunimi shumë i frytshëm që FSK-ja ka me Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë. Me këtë rast komandant Kastrati tha se në kuadër të FSK-së kemi 2,36 për qind pjesëtarë të komuniteti turk që jeton në Kosovë, kemi laborator të gjuhës turke të realizuar në bashkëpunim me FA të Turqisë. Gjithashtu, gjeneral Kastrati e falënderoi shefin e FA-së të Turqisë për mundësitë e tyre të ofruara për shkollimin e kadetëve të FSK-së në Turqi, e në kuadër të kësaj edhe në Kolegjin e Luftës. Po ashtu, gjeneral Kastrati e falënderoi gjeneralin Ozel edhe për pajisje që ushtria e tij i ka ofruar për FSK-në. Ai njëherësh kërkoi nga FA- të e Turqisë që të vazhdojnë ta mbështesin FSK-në, në qëllimin e saj, për zbarkime jashtë vendit në misione paqësore.

Nga ana e tij Nexhdet Ozel, shef i FA të Turqisë, pasi shprehu kënaqësinë për ftesën e bërë nga FSK-ja dhe për vizitën që po realizon, duke shtuar se ndjehet "si në mes vëllezërish". Gjeneral Ozel shprehu gatishmërinë e tij dhe të Forcave të Armatosura të Turqisë se do të vazhdojnë t'i japin përkrahje FSK-së në mënyrë që siç tha Ai, FSK-ja të jetë e përparuar dhe profesionale. Shefi i FA të Turqisë,



gjithashtu, përgëzoi gjeneral Kastratin për arritjen dhe njohjen nga NATO-ja të Kapaciteteve të Plota Operacionale për FSK-në. Përveç që ne jemi mentorues tha gjeneral Ozel, ne dëshirojmë që të zhvillojmë operacione stërvitore të përbashkëta. Ne tha gjeneral Ozel jemi duke iu dhënë mbështetjen e duhur dhe konkrete, dhe se ne më shumë vëmendje përcjellim Planin e NATO-s për mbështetje të FSK-së. Në fund gjenerali Ozel tha se Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë mbështesin FSK-në në synimin e saj për të marrë pjesë në operacione të paqes.

Në takimin e përbashkët të të dyja delegacioneve morën pjesë edhe gjeneral major Rrahman Ramazëvendëskomandant i FSK-së dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT), Shkelzen Sylajsekretar i përgjithshëm në Ministri, gjeneral brigade Zymer Halimidrejtor i Drejtorisë së Operacioneve, gjeneral brigade Bashkim Jashari- drejtor i Inspektoratit të FSK-së, Haxhi Shaladrejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli- zëvendëskomandant i KFT-së dhe nënkolonel Hasan Hoxhashef i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri. Ndërsa nga ana e delegacionit të Republikës së Turqisë ishin; ambasadorja e Republikës së Turqisë në Kosovë, Songul Ozan, kolonel Zorlu Topaloglu, kolonel Sevket Cumaoglu, kolonel Erdal Dodurga, kolonel Fedai Unsal, kolonel Muammer Aygar, kolonel Hasan Aydogdu, Ahenk Dereli.

Mirënjohje për këshilltarët e MCAD-it dhe të KFOR-it

Në Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), me rastin e përfundimit të punës së këshilltarëve të MCAD-s, (Divizionit Këshillues Ushtarako-Civil të NATO-s) në FSK, u organizua një takim ceremonial, ku morën pjesë; zëvendësministrat e MFSK-së, Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi, komandanti dhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe gjeneralmajor Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Farina, drejtori i NLAT-it (ekipi këshillues-ndërlidhës) gjeneralbrigade Vagner, si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pasi përshëndeti komandantin e KFOR-it, gjeneralin Farina dhe gjeneralin Norbert Vagner, si dhe të gjithë oficerët e FSK-së dhe KFOR-it, falënderoi në mënyrë të veçantë përfaqësuesit e MCAD-it, (Divizionit Këshillues Ushtarako-Civil të NATO-s) në FSK-në, për punën e tyre profesionale dhe për angazhimin dhe kontributin e tyre të dhënë në ngritjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së, gjatë këtyre pesë viteve, të cilët janë pjesë e suksesit të FSK-së.



Me këtë rast, gjeneral Kastrati tha se MCAD-ja e ka ndihmuar vazhdimisht FSK-në, ku fokusi kryesor ka qenë ofrimi i trajnimeve në nivel individi dhe njësie. Më vonë, fokusi u zhvendos nga trajnimi për mentorimin dhe këshillimin e FSK-së në operacione, rekrutime, trajnime, logjistikë dhe çështje të tjera. Më tej gjeneral Kastrati tha se FSK-ja dhe Ai personalisht vlerësojnë përpjekjet e KFOR-it, në zhvillimin e FSK-së në një forcë profesionale dhe kompetente që e pavarur mund t'i përmbushë detyrat e veta. Suksesi i FSK-së është suksesi ynë i përbashkët, dhe të arriturat e FSK -së janë të arriturat tona të përbashkëta me përfaqësuesit e MCAD-së. Në korrik, NATO ka deklaruar Plotësimin e Kapaciteteve Operacionale për FSK-në. Kjo do të thotë se FSK-ja është plotësisht e aftë për të kryer detyrat e përcaktuara sipas misionit dhe po shihet edhe nga partnerët tanë si një partner i besueshëm. Që nga themelimi, FSK-ja, bazuar në zhvillimin e saj, ka përdor praktikat më të mira demokratike, me mbështetjen nga aleatët e NATO-s. Ne jemi krenarë për arritjet tona, dhe do të vazhdojmë ta zhvillojmë FSK-në në një forcë që ofron mbështetje për të gjithë qytetarët tanë dhe asistencë për të gjithë në vend dhe rajon. Më pastaj, komandanti i FSK-së tha se ne vazhdojmë përpara për të zhvilluar marrëdhëniet tona profesionale me KFOR-in dhe ndërtimin e të ardhmes tonë me Ekipin Këshillues-Ndërlidhës të NATO-s.

Ndërsa, drejtori i NLAT-it (Ekipi Ndërlidhës Këshillues), gjeneral brigade Norbert Vagner, ka përgëzuar për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të veçantë integrimin e përfaqësuesve të komuniteteve. Në fund, gjenerali Vagner premtoi se edhe në të ardhmen do ta ndihmojnë FSK-në përmes këshillimeve profesionale.

Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, së bashku me zëvendëskomandantin e FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Ramën, komandantin e KFOR-it, gjeneral brigade Salvatore Farina dhe drejtorin e NLAT-it, gjeneralin Wagner, ndanë mirënjohje për përfaqësuesit e Divizionit Këshillues Ushtarako-Civil të NATO-s, (MCAD) me motivacionin për shërbim dhe për kontributin e dhënë në zhvillimin e FSK-së në një forcë kompetente.

Komandanti i FSK-së takoi përfaqësuesit e tri delegacioneve të Ushtrisë së Kroacisë

Tri delegacione të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ushtrisë së Kroacisë, ishin për vizitë pune treditore (16, 17 dhe 18 tetor 2013) në Ministrinë e FSK-së dhe në Komandën e Forcave Tokësore (KFT).

Kjo vizitë realizohet në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Bilateral në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe të Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë, për vitin 2013.

Qëllimi i vizitës së delegacioneve të Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, është vazhdimi i bashkëpunimit të dyanshëm si dhe shkëmbimi i përvojave dhe të njohurive në fushat përkatëse.

Fillimisht, mysafirët nga Kroacia i priti komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili pasi që ju uroj mirëseardhje e falënderoi Kroacinë për mbështetjen e saj të vazhdueshme për FSK-në. Gjeneral Kastrati, me këtë rast, e njoftoi delegacionin e Kroacisë me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, bashkëpunimin rajonal dhe në veçanti bashkëpunim me SHBA-n, shkollimin, trajnimet si dhe për Rishikimin e Sektorit Strategjikë të Sigurisë për FSK-në.

Delegacioni i Kroacisë u pritë në takime të ndara pune edhe në Departamentin për Siguri dhe Bashkëpunim në MFSK-së, ku me nënkolonel Hasan Hoxha, shef i këtij departamenti, diskutuan rreth përvojave të mira të Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë, në procesin drejt anëtarësimit në NATO dhe mekanizma të tjerë, ndërsa në Departamentin për Politika dhe Plane me z. Faruk Gecin, shef i këtij departamenti, biseduan për fushat me rëndësi të veçantë për MFSK-në dhe FSK-në.

Ndërsa, dy delegacionet e tjera të Ushtrisë së Kroacisë vazhduan aktivitetet e tyre, njëri në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të BRSH-së në Istog dhe delegacioni tjetër në Komandën e Forcave Tokësore, përkatësisht në Policinë Ushtarake të FSK-së. Në fund të takimit treditorë të dy delegacionet u akorduan për mënyrat e bashkëpunimit në mes departamenteve përkatëse, për formën e realizimit dhe thellimin e këtij bashkëpunimit, me qëllim të përfitimit të njohurive dhe eksperiencave të dyanshme.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

FSK-ja në alarm, për ushtrimin fushor "Shqiponja 2"


Gjeneralmajor Rrahman Rama, zëvendëskomandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), përkatësisht komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), që nga orët e hershme të mëngjesit të datës 3 tetor, me urdhër të veçantë, alarmoi të gjitha njësitë e KFT-së, për gjendje gatishmërie, me rastin e zhvillimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 2".
Qëllimi i FSK-së është që nëpërmjet ushtrimit "Shqiponja 2" të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të njësive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara dhe me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren.
Sipas misionit të tyre, në ushtrim do të jenë të përfshirë; Komanda e Forcave Tokësore, Brigada për Reagim të Shpejtë me tri batalionet e Reagimit të Shpejtë, Brigada për Mbështetje Operacionale me Regjimentin për Mbrojtje Civile, Batalioni i Xhenios dhe i Logjistikës, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, si edhe njësitë vartëse të KFT-së; Njësia Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave, Policia e Forcës, Kompania e Komunikimit dhe Kompania e Mjekësisë.
Konvojet e Forcës së Sigurisë së Kosovës do të marshojnë nga vendbazimet e tyre nga Prishtina, Ferizaj, Gjilani, Mitrovica, dhe Pomozotini për në rajonet e grumbullimit, ku aktiviteti do të jetë i përqendruar në komunat: Pejë, Istog, Prizren dhe Klinë.
Për këtë qëllim FSK-ja ka bërë të gjitha përgatitjet dhe marrëveshjet paraprake me komunat dhe të gjitha institucionet që do të jenë pjesë e këtij ushtrimi, me qëllim



që mbarëvajtja e ushtrimit të zhvillohet sipas planifikimeve.
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës njoftojnë opinionin e gjerë dhe gjithë qytetarët se lëvizjet e konvojeve të FSK-së do të bëhen për qëllim ushtrimi. Pra dislokimi i njësive dhe lëvizja e konvojeve në rrugët magjistrale dhe lokale do të vërehen që nga 3 tetori, për dhjetë ditë me radhë, gjatë 24 orëve dhe do të bëhen vetëm për qëllime ushtrimi.

Pjesëtarët e Batalionit të Xhenios përfundojnë me sukses projektin për "Përmirësimin e Poligonit të Kalitjes Fizike"

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së (KDS), gjeneralbrigade Enver Cikaqi së bashku më komandantin e Batalionit të Xhenios, nënkolonel Zejnullah Prokshi si dhe oficerin komandues të ekipit mentorues, kapiten Michael Parton, certifikuan pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të FSK-së, për përfundimin e punimeve, gjatë katër javëve, në përmirësimin e Poligonit të Kalitjes Fizike, më 4 tetor 2013, në Ferizaj.
Gjeneralbrigade Enver Cikaqi i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për punën dhe profesionalizmin e tyre, si dhe për përkushtimin në realizimin e detyrave me shumë përgjegjësi. Ai, po ashtu e falënderoi edhe kapitenin Parton, për bashkëpunimin e pjesëtarëve



Britanezë me pjesëtarët e FSK-së. "Pjesëtarët e Batalionit të Xhenios kanë fituar përvojë shumë të nevojshme për projektet e ardhshme, ku kanë përvetësuar aftësi në aspektin teknik profesional të inxhinierisë, po ashtu edhe në menaxhimin e projekteve në tërësi. Gjithashtu përvoja e fituar në këtë projekt për ndërtimin e poligoneve do të na shërbejë edhe për ndërtimin e poligoneve tjera dhe atyre 300 m", tha gjeneralbrigade Enver Cikaqi.
Projekti për Përmirësimin e Poligonit të Kalitjes Fizike ka qenë i domosdoshëm për trajnimet fizike të cilat kryhen në KDS, në Ferizaj. Plani i detajuar për realizimin e këtij projekti është ofruar nga inxhinierët e Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar, të cilët kanë asistuar për 4 javë rresht implementimin e këtij projektit ku kanë qenë të angazhuar 17 pjesëtarë të Batalionit të Xhenios së FSK-së.
Oficeri komandues i ekipit mentorues, kapiteni Michael Parton, u shpreh shumë i kënaqur më bashkëpunimin me pjesëtarët e FSK-së. Ai, theksoi se bashkëpunimi dhe mikpritja e FSK-së, janë shembulli më i mirë që kanë pasur deri me tani me ushtritë tjera."Ne nga ushtria britaneze kemi përvojë bashkëpunimi me ushtritë nga vende të ndryshme të botës, por ju siguroj se mikpritjen që kemi gjetur në FSK, nuk e kemi gjetur askund tjetër. Ju falënderoj për entuziazmin dhe përkushtimin që treguat gjatë këtij trajnimi. Ju keni qenë jashtëzakonisht pozitiv në të gjitha aspektet, andaj ju bëj thirrje për të vënë aftësitë tuaja të reja në praktikë" përfundoi kapiteni Parton.
Ky projekt ka përfshirë heqjen e 6 pengesave, përmirësimin e 12 të tjerave si dhe ndërtimin e 4 pengesave të reja. Janë përfshirë lëmi të inxhinierisë, murimit, vendosja e anësoreve, ndërtimi i themeleve, demolomi i masave të betonit, saldimi i pengesave, etj.

Departamenti për Inspektime i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë dhe Inspektorati i FSK-së, thellojnë bashkëpunimin

Një delegacion i Departamentit për Inspektim të Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë, i udhëhequr nga shef i këtij departamenti, z. Pero Petrovski, qëndroi për vizitë zyrtare dyditore (8 dhe 9 tetor 2013) në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
Ky takim u realizua në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Bilateral në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, për vitin 2013.
Qëllimi i vizitës po edhe i takimeve ishte vazhdimi i bashkëpunimit të dyanshëm, shkëmbimi i përvojave dhe të njohurive në fushën e inspektoratit.
Delegacioni i Maqedonisë, në Ministrinë e FSK-së, u prit nga nënkolonel Agim Vrellaku. Inspektori i FSK-së me bashkëpunëtorë i njoftoi mysafirët për strukturën, misionin, funksionet dhe aktivitetet e Inspektoratit të FSK-së, në përgjithësi.
Delegacioni i Inspektoratit të Ushtrisë së Maqedonisë, gjatë qëndrimit në Kosovës, ditën e dytë, vizitoi edhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj, ku u prit nga zëvendëskomandanti, kolonel



Irfete Spahiu.
Kolonel Spahiu, gjithashtu i njoftoi mysafirët me organizimin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, me aktivitetet e përgjithshme që mbahen në KDS, si dhe me kapacitetet që ka kjo qendër trajnuese.
Gjatë këtij takimi të dy delegacionet biseduan edhe për mënyrat e bashkëpunimit të mëtejmë në mes të Inspektoratit të MFSK-së dhe Departamentit të Inspektoratit të Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë, për formën e realizimit dhe thellimin e këtij bashkëpunimi, me qëllim që të përfitohen njohuri dhe eksperienca të dyanshme.
Delegacioni i inspektorëve nga Maqedonia, në fund, vizitoi Qendrën e Stërvitjes dhe Qendrën e Trajnimit, ku u informua nga afër me trajnimet që ofrojnë këto qendra të KDS-së.

Intervistë me drejtorin e ushtrimit fushor "Shqiponja 2" kolonel Naim Hazirin

FSK-ja me sukses realizoi ushtrimin fushor “Shqiponja 2”









"Forca Jonë": Zotëri kolonel, cili ishte qëllimi i mbajtjes së ushtrimi fushor "Shqiponja 2"?
Kolonel Naim Haziri: Mbajtjen e ushtrimit fushor, ka për qëllim zhvillimin dhe mirëmbajtën e kapaciteteve operacionale nga njësitë, si të nivelit taktik ashtu edhe operativ, që nga organizimi, planifikimi, drejtimi i veprimeve dhe zbatimi i procedurave, duke nisur nga marrja e alarmit, ekzekutimi i operacioneve e deri tek përfundimi i ushtrimit. Ushtrimi është mbajtur me qëllim që të realizohen objektivat e parapara paraprakisht sipas Direktivës së Komandantit të FSK-së, siç janë: planifikimi, organizimi, koordinimi, realizimi dhe vlerësimi i ushtrimit; zbatimi i procedurave të alarmimit, grumbullimi, lëvizja, reagimi dhe ri-dislokimi; zbatimi i procesit të vendimmarrjes; zbatimi i komandimit, kontrollit dhe komunikimit; zbatimi i procedurave të mbështetjes administrative dhe logjistike; zbatimi i shërvitjeve në kushte të vështira të shikueshmërisë dhe eliminimi i mangësive nga ushtrimet e kaluara.

"Forca Jonë": Kur i keni filluar përgatitjet për realizimin e ushtrimit fushor?
Kolonel Naim Haziri: Mbajtja e ushtrimit fushor ka qenë e planifikuar sipas planeve vjetore, të trajnimeve, për vitin 2013, dhe këtë e ka aprovuar komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Në muajin prill është lëshuar Direktiva e Komandantit të Forcave Tokësore (KOMFT), ku janë specifikuar të dhënat e përgjithshme për ushtrimin, si: qëllimi, objektivat, koncepti i realizimit të ushtrimit dhe ndarja e përgjegjësive, për fazën planifikuese dhe për fazën e realizimit. Në funksion të kësaj, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më ka ngarkuar me detyrën e drejtorit të ushtrimit, me qëllim të koordinimit të gjitha aktiviteteve në fazën e planifikimit dhe realizimit sipas specifikave të caktuara dhe analizën pas veprimit të ushtrimit. Në proces të planifikimit janë realizuar 4 konferenca; më 12 qershor, është realizuar Konferenca e Specifikimeve Teknike, më 2 korrik, Konferenca Fillestare e Planifikimit (KFP), më 5 gusht, Konferenca Kryesore e Planifikimit (KKP) dhe më 30 gusht, Konferenca Përfundimtare Koordinuese. Gjithashtu, në funksion të saj, kemi realizuar edhe dy ushtrime paraprake, një në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Qendrën e Trajnimit Kolektiv (QTK) në Ferizaj, ku kemi realizuar Procesin e Marrjes së Vendimeve Ushtarake (PMVU), më 02-06 shtator dhe ushtrimi në Vend- Komandë pa Trupa (UVK), më 23-27 shtator 2013.

"Forca Jonë": Cili ishte skenari i ushtrimit?
Kolonel Naim Haziri: Situata ka qenë e dizajnuar në atë mënyrë që njësitë tona të kenë mundësi që të reagojnë në përputhje me misionin, duke u ballafaquar me të gjitha sfidat. Sipas skenarit, Republikën e Kosovës muajt e fundit e ka përfshirë një mot i ligë të përcjellë me reshje të rrëmbyeshme dhe me shtrëngata, këto kryesisht kanë qenë të theksuara në pjesën jugperëndimore të Kosovës, kryesisht në regjionin e Prizrenit dhe të Pejës, ku si pasojë e motit të lig, kemi pas dëmtime të infrastrukturës, përmbytje të shumta, zhvendosje të qytetarëve nga pronat, zhdukje të qytetarëve, plaçkitje, zjarre, fusha të minuara, paraqitje të epidemive, etj.
Në këtë rast, autoritetet civile emergjente kanë dështuar të ballafaqohen me situatën, andaj Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar që FSK-ja të ngritë gatishmërinë dhe të jetë e gatshme për t'i mbështetur autoritet lokale në menaxhimin e situatës në terren.

"Forca Jonë": Sa ishte FSK-ja e përgatitur për t`ju përgjigjur alarmit dhe situatës në terren?
Kolonel Naim Haziri: Në përgjigje të kërkesës së Qeverisë së Kosovës, ne kemi lëshuar urdhrin e parë paralajmërues, më 03.10.2013, për ngritje të gatishmërisë dhe për reagim në vendndodhje. Ne jemi të kënaqur për këtë, sepse pjesëtarët tanë 92%, pas dhënies së alarmit, kanë qenë në vendbazimet e tyre të përhershme. Brigadat dhe batalionet kanë filluar me procesin e planifikimit, për t`u ballafaquar me situatën e krijuar, në përputhje me listën e detyrave esenciale për zbatim të misionit në terren.

"Forca Jonë": Zotëri kolonel, cili ka qenë koncepti i përgjithshëm i ushtrimit fushor ?
Kolonel Naim Haziri: Koncepti i përgjithshëm i ushtrimit fushor (UF) ka qenë i fokusuar mbi bazën e kërkesave të mundshme për mbështetje në situata krize, ku përmes këtij ushtrimi bëhet përgatitja e njësive të FSK-së në nivelin operativo-taktik, me mundësi vlerësimi në fusha të caktuara specifike. Ushtrimi ka qenë i simuluar me situata sa më reale, për të sfiduar njësitet e FSK-së në simulimin e situatave, siç ishte Batalioni i Parë i BRSH-së, i komanduar nga major Haki Xhemajli, si forcë opozitare. Angazhimi i njësive të FSK-së, ka qenë i kombinuar. Koncepti i operacionit të ushtrimit fushor „Shqiponja 2" është realizuar në 4 faza :

Faza Parë-Misioni

Kjo fazë ka filluar me publikimin e planit operacional dhe ka vazhduar deri tek kalimi në fazën e dislokimit. Përgjatë kësaj faze njësitet e KFT-së kanë zhvilluar dhe rishikuar planet mbështetëse dhe procedurat, kanë testuar dhe bërë provat përfundimtare para zbarkuese, marrjen e masave dhe informimin e personelit me detyrat e tyre.

Faza e Dytë;Dislokimi i njësive në vendincidente

Kjo fazë ka filluar me ngritjen e Qendrës së Bashkuar Operacionale (QBO). Kjo qendër është formuar nga shtabet e dy brigadave; Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe Brigadës së Mbështetjes Operacionale dhe është komanduar nga komandanti i BRSH-së, gjeneralbrigade Nazmi Brahimaj. Lëvizjen e njësive nga bazat e përhershme drejt zonës së grumbullimit dhe ngritjes së bazave të përparme operuese, përgatitjeve për operim dhe ekzekutim të operacioneve. Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO) ka operuar në zonat vijuese të përgjegjësisë: Zonën Operacionale (ALFA) në Istog, ku kemi pas të vendosur një batalion plus dhe është komanduar nga nënkolonel Mehmet Lladrofci, si dhe Zonën Operacionale (BRAVO) në Prizren, gjithashtu një batalion plus dhe është komanduar nga nënkolonel Arsim Shaqiri.

Faza e Tretë- Reagimi në situata

Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO) ka organizuar të gjitha forcat me personel dhe me pajisje, në të dy bazat e përparme operacionale, për reagim në vendincidente. Njësitë në vartësi të QBO-së, kanë qenë: Njësia Ndërlidhëse për Reagim Krizash (NJNRK),PF, KK, KM.

Faza e Katërt-Ri-dislokimi

Kjo fazë është realizuar me fillimin e kthimit të njësive në bazë nga rajonet e grumbullimit. Kryesorja e kësaj faze është kthimi i gjendjes në normalitet, transferimi i kompetencave të autoritetet civile lokale, kthimi i njësive në bazë, heqja e gatishmërisë. Qëllimi përfundimtar i kësaj faze është që njësitë të jenë të gatshme për operacionet e ardhshme.

"Forca Jonë ": Sa ishte kohëzgjatja e ushtrimit dhe cilat ishin incidentet e injektuara ?
Kolonel Naim Haziri: Ushtrimi fushor "Shqiponja 2" ka zgjat tetë(8) ditë, 24 orë dhe është zhvilluar në terren. Injektimet në total kanë qenë 52 në të dy zonat operacionale. Operacionet janë zhvilluar edhe në kushte të vështirësuara të shikueshmërisë. Në ushtrim janë angazhuar 1951 pjesëtarë, 92.9%, me gjithsej 161 automjete, duke përfshirë edhe ato jo taktike. Vlen të përmendet se në të njëjtën kohë, ne nuk i kemi ndërprerë edhe trajnimet e planifikuara më parë e që kanë qenë duke u zhvilluar nga instruktorë amerikan në Regjimentin e Mbrojtjes Civile dhe trajnimet jashtë vendit, si ato individuale dhe kolektive.

"Forca Jonë": Cila ka qenë mbështetja e KFOR-it, dhe shteteve të tjera që keni marrëveshje bashkëpunimi?
Kolonel Naim Haziri: Gjatë zhvillimit të ushtrimit fushor, kemi pas një asistencë profesionale nga ekipet e oficerëve dhe nënoficerëve nga SHBA-së, të cilët kanë qenë të sistemuar në dy nivele të komandim-kontrollit. Në QBO kanë qenë kapiten Gullixson dhe OR7 Harper, Në BPO Alfa (Pejë) major Macri, OR8 Tello, OR7 Clayton, në BPO Bravo (Prizren), kapiten Cormier, OR8 Miranda, OR7 Herrera. Nga NLAT dhe ekipet mobile turke që janë marrë me trajnimin e njësive tona, në nivel kompanie, gjithashtu kemi pas një asistencë gjatë gjithë kohës së realizimit të ushtrimit.

"Forca Jonë": Cili ishte niveli i bashkëpunimit me udhëheqësit e komunave në lokacionet e të cilëve është mbajtur ushtrimi?
Kolonel Naim Haziri: Para fillimit të ushtrimit fushor, Departamenti për Marrëdhënie Civilo-Ushtarake ka bërë marrëveshje me të gjithë pronarët e pronave ku kemi zhvilluar ushtrimin, si ato private dhe publike. Jemi shumë të kënaqur me gatishmërinë e komunarëve dhe të qytetarëve për t`i afruar mundësi FSK-së që të realizojë ushtrimin fushor pa asnjë problem. Sigurisht që edhe ne kemi marrë obligime, që në rast të dëmtimit të pronave të tyre të bëjmë rregullimin e tyre duke i kthyer në gjendje të mëparshme.

"Forca Jonë": Ushtrimin fushor e përcollën presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, ekipe profesionale të NATO-s, etj, cili ishte vlerësimi i tyre?
Kolonel Naim Haziri: Na gëzon fakti se, në Ditën D, për një vizitë zyrtare ishte edhe presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga e shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, të cilët e vlerësuan lart ushtrimin.







Gjithashtu, ushtrimi u vlerësua lartë edhe nga vëzhguesit-kontrolluesit e ushtrimit fushor si dhe nga oficerë amerikan, të cilët u shprehen se ushtrimi fushor i ka realizuar objektivat, që kanë qenë të paraparë të arrihen.

"Forca Jonë": Si drejtor i ushtrimit fushor, për fund a keni edhe diçka për të shtuar ?
Kolonel Naim Haziri: Vlen të theksohet se edhe pse ushtrimi është zhvilluar për disa ditë me radhë, gjatë 24 orëve pa ndërprerë, duke përfshirë edhe 1/3 e operacioneve që janë realizuar natën në kushte jo edhe shumë të përshtatshme atmosferike, motivimi i pjesëtarëve ka qenë i jashtëzakonshëm. Ky fakt neve si epror të lartë, duke përfshirë edhe komandantin e KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Ramën, na jep shumë besim se ne kemi ngritë një forcë shumë profesionale, të gatshme për t`u ballafaquar me të gjitha sfidat që i kanosen vendit tonë.



Nënkolonel Jeton Dreshaj, shef i Shtabit të BRSH-së

Hera e parë që u formua Qendra e Bashkuar Operacionale në një ushtrim fushor të FSK-së





Ngritja e një Qendre të Bashkuar Operacionale (QBO) me kombinim të dy brigadave operacionale dhe mbështetjen e njësive të specializuar ka krijuar mundësi dhe lehtësira në menaxhimin, koordinimin dhe komandimin e njësive gjatë operacioneve. Si organizim i ri, duke marrë për bazë edhe vështirësitë procedurale dhe doktrinare, QBO ka ngritur nivelin e planifikimit dhe Procesin e Marrjes së Vendimeve Ushtarake. Kjo praktikë mund të jetë organizim adekuat edhe në të ardhmen, qoftë gjatë ushtrimit fushor apo edhe gjatë operacioneve reale. Komandimi dhe udhëheqja me të gjitha njësitë pranshtabore operacionale dhe mbështetëse, ka qenë më e lehtë, për shkak të eliminimit dhe shkurtimit të rrugës në komandim, kontroll dhe nivele komanduese. Thjeshtësia në organizime të tilla krijon lehtësira gjatë procesit të komandimit dhe udhëheqjes me njësi, gjë që ka treguar edhe puna e përbashkët në Qendrën e Bashkuar Operacionale. Bashkëngjitjet dhe shkëputjet nga vartësia, organizimi për detyra të mirëfillta ushtarake me një Qendër të Bashkuar Operacionale në nivel Operacional dhe të Bazave të Përparme Operuese në nivel taktik, ka krijuar lehtësira në kohë, gjë që është kritike në operacione të tilla dhe qartësi në vijën e komandim- kontrollit përgjatë niveleve komanduese. Gjatë ushtrimit fushor niveli i komunikimi me Drejtorinë e Ushtrimit në KFT dhe me drejtuesit e BPO-ve, si dhe organizimi strukturor i ushtrimit, komunikimit dhe koordinimit të veprimeve ka qenë në nivelin më të lartë profesional.

Gjatë procesit të planifikimit, bazuar dhe në misionin e Komandës madhore është bërë organizimi për detyrë dhe është ndërtuar Koncepti Operacional duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë për të gjitha njësitë operacionale, mbështetëse, si edhe për njësitë e specializuara. Zbarkimi dhe ngritja e Bazave të Përparme Operuese (ndërtimi i kampeve) është bërë nga njësitë e FSK-së. Incidentet e ngritura gjatë UF-së kanë qenë shumë sfiduese dhe realiste, të cilat pa një planifikim dhe organizim të mirëfilltë ka qenë vështirë të menaxhohen, për shkak të intensitetit dhe natyrës së incidenteve. Çdo detyrë e dhënë nga QBO është realizuar me njësi adekuate, bazuar në Procedura Standarde Operative dhe rregullat për përdorim të forcës. Në dy bazat e Përparme Operuese të përfshirë kanë qenë mbi 600 pjesëtarë, ndërsa në gjendje gatishmërie kanë qenë 90 % e personelit të FSK-së. Ndërrimi i trupave në terren është bërë me plan përmes sistemit (operacion, gatishmëri, pushim).

Ndërsa, mbështetja e ekipeve të NATO-s, (NLAT), gjatë ushtrimit, kanë qenë në cilësinë e këshilluesve dhe vëzhguesve. Kemi pasur një bashkëpunim profesional dhe është frytdhënëse përvoja dhe profesionalizmi i këtyre ekipeve, qoftë në punën tonë të përditshme, qoftë në organizime të tilla me një shpejtësi të lartë trajnuese. Gjatë UF-së, nga Ushtria amerikane, kemi pasur një ekip të specializuar vëzhgues dhe vlerësues të ushtrimeve të tilla. Ky ekip ka vëzhguar dhe vlerësuar në të gjitha nivelet planifikuese, komanduese të oficerëve dhe nënoficerëve, për çka edhe kanë dhënë vlerësimet e tyre në një raport të veçantë të prezantuar në KFT. Vlen të theksohet që përshtypjet e para kanë qenë shumë pozitive dhe profesionale. Procesi i mësimeve të mësuara është i rregulluar me Procedura Standarde të cilat janë në fuqi në FSK. Ne jemi në procesin e analizimit në të gjitha nivelet. Mësimet e mësuara do të publikohen gjatë Analizës Pas Vepruese dhe do të dërgohen në të gjitha nivelet. Mangësitë të cilat identifikohen, ne do të përpiqemi që përmes procesit planifikues dhe planeve të veprimit për 2014 të eliminohen dhe të mos përsëriten. Qëllimi i stërvitjeve është identifikimi i mangësive dhe nxjerrja e mësimeve të mësuara. Ushtrime të tilla krijojnë mundësi vlerësimi në të gjitha nivelet, identifikojnë mangësitë dhe u japin udhëheqësve dhe komandantëve të njësive pasqyrën e qartë të nivelit të gatishmërisë dhe të trajnimit të njësive në personel dhe pajisje. UF i fundit ka tejkaluar pritshmërinë jo vetëm timen personale, por edhe të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë ushtrim. Por sido që të jetë nuk ka vend për kënaqësi, por për vazhdim të punës profesionale dhe përkushtim në të gjitha nivelet për trajnime dhe aktivitete të ardhshme.



Komandanti i Batalionit të Parë, të BRSH-së, major Haki Xhemajli:

Planifikimi i mirë i ushtrimit fushor "Shqiponja 2" dha rezultate të larta



Batalioni i Parë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë ka marrë pjesë me 141 pjesëtarë, të angazhuar nga kompanitë 1A dhe 1C, pastaj ekipi i koordinatorëve me 10 pjesëtarë, të angazhuar në dy zonat e operacioneve, ekipi i mbikëqyrjes nga personeli i Batalionit të Parë dhe pjesa tjetër e personelit ka qëndruar në gatishmëri gjatë gjithë kohës. Gjithashtu në këtë ushtrim kanë qenë të angazhuar edhe pjesëtarë të komuniteteve joshqiptarë.

Batalioni i Parë në këtë ushtrim kishte për detyrë të luante rolin e forcës opozitare. Detyra kryesore ka qenë që t'i sfidojë kolegët nga njësitet tjera të FSK-së, duke simuluar incidente të ndryshme të cilat është dashur të duken sa më reale. Të gjitha incidentet të cilat i ka planifikuar Drejtoria e ushtrimit janë ekzekutuar në terren, duke krijuar rrethana mjaft reale për dy batalionet tjera të BRSH-së dhe njësitet e specializuara të FSK-së.

Ky ka qenë ushtrimi i parë fushor i cili e ka verifikuar gjendjen reale të njësive të FSK-së, pasi edhe ekipet planifikuese edhe ekipet vlerësuese kane qenë nga vetë FSK-ja.

Sipas zv. komandantit, major Haki Xhemajli, përgatitjet e këtij ushtrimi kanë filluar një muaj më herët, më qëllim që inskenimet të duken sa më origjinale në incidente të caktuara. Sipas tij, rezultati i batalionit të tij është arritur falë angazhimit dhe gatishmërisë së lartë të personelit. "Jam i impresionuar nga mënyra e reagimit dhe nga profesionalizmi i lartë i këtyre pjesëtarëve gjatë ushtrimit. Më lehtë është që të përgatisësh një civil për të formuar si ushtarak, se sa një ushtarak ta bësh që të harrojë standardet me të cilat është i mishëruar".

Major Xhemajli, thotë se UF " Shqiponja 2" vlerësohet si ushtrimi më i suksesshëm deri më tani falë një planifikimi shumë të mirë dhe në të njëjtën kohë është për t'u vlerësuar lartë ekzekutimi i këtij ushtrimi. Këtë e dëshmon më së miri gatishmëria e lartë e personelit të angazhuar në ushtrim, të cilët i kanë kryer detyrat e veta në shkallën më të lartë të përgjegjësisë. ,,Unë marr të drejtën të them që FSK-ja është e gatshme që të evoluojë në mision dhe të marr detyra shtesë, ketë e ka dëshmuar më së miri UF" Shqiponja 2", ku edhe ekipet nga

Ajova kanë bërë komentet e tyre pozitive për rezultatet dhe të arriturat e FSK-së".

Gjatë këtij ushtrim një rol pozitive ka luajtur edhe angazhimi i koordinatorëve, të cilët kanë pas për detyrë që të sinkronizojnë veprimet e nevojshme në përputhje me skenarin. Ky është një mësim i mësuar që ne duhet ta përdorim edhe në të ardhmen.



Nënkolonel Arsim Shaqiri

"FSK-ja do bëhet model i profesionalizmit për shumë ushtri në rajon"

Komandant i Batalionit të 3-të të BRSH-së, në Mitrovicë, nënkolonel Arsim Shaqiri, tha se: Ushtrimi i Forcës së Sigurisë të Kosovës "Shqiponja 2", tregoi edhe një herë nivelin e profesionalizmit të njësive të FSK-së; nivel ky i cili po ngritët çdo ditë e më shumë, falë punës së palodhshme të pjesëtarëve të njësive të FSK-së, si dhe trajnimeve të bëra gjatë tërë vitit për reagime dhe operacione të tilla, pasi që FSK-ja duhet të jetë çdoherë e përgatitur për t'u ballafaquar me situata të rënda.Komandanti i Batalionit të 3-të për Reagim të Shpejtë, nënkolonel Arsim Shaqiri, në ushtrimin fushor "Shqiponja 2", ishte udhëheqës i BPO-së, i cili ka pasur në vartësi 380 pjesëtarë. Batalioni i 3-të ishte bartës i operacionit dhe ka vepruar si "Task forcë" të cilit i janë bashkangjitur edhe njësitet e specializuara, si: NJNRK, Togu i Logjistikës,Togu i PF, Skuadra e Komunikimit, Skuadra e EOD-së, Skuadra e KSH, Skuadra e MKABK, Togu i Xhenios dhe një Skuadër Mjekësore. Ashtu siç e determinon doktrina dhe praktika ushtarake, kryesisht bartës të incidenteve kanë qenë komandantët e njësive manovruese, ndërsa në mbështetje i kanë pas njësitet e specializuara, por ka pasur edhe situata të tilla ku zgjidhja më e mirë ka qenë të angazhohen vetëm njësitë e specializuara. Në këto raste komanda e incidentit i është dorëzuar komandantit të njësisë specialistike në intervenim. Nënkolonel Shaqiri shprehet i kënaqur me rezultatin e jashtëzakonshme të treguar gjatë ushtrimit fushor, ku pa marrë parasysh rrethanat, pjesëtarët e FSK-së kanë arrit një sukses të shkëlqyeshëm dhe janë trajnuar e përgatitur për t'u ballafaquar me rrethana dhe kushte të jashtëzakonshme, si në nivel BPO-je ashtu edhe në nivele të njësive manovruese. Nëse vazhdojmë me ritmin e njëjtë të trajnimeve, Forca e Sigurisë së Kosovës, do të bëhet model i profesionalizmit për shumë ushtri në rajon thotë nënkolonel Shaqiri. Në ditën D të ushtrimit fushor, Batalioni i Tretë për Reagim të Shpejtë, i është bashkangjitur një ekip i mentorusve nga Ushtria amerikane me qëllim të mentorimit të personelit të Shtabit dhe Kompanive të Bat-3.Ekipi i mentorusve, përbëhej nga kapiteni Justin Cormier, oficeri luftarak Richardson, rreshter majori Rich Miranda dhe rreshter i parë Herrera. Menjëherë pas mentorimit



fillestar që i është bërë Shtabit të Batalionit, kapiteni Cormier deklaroi se përshtypjet e para flasin se, Shtabi i Batalionit është në atë nivel profesional saqë kontributi im në këtë Shtab është shumë i kufizuar, madje kam përshtypjen gati edhe i panevojshëm.Edhe përkundër modestisë së treguar nga kapiteni Cormir, komandanti i Njësisë, tha së ekipi monitorus nga Ushtria e SHBA-ve, ka dhënë një kontribut të shkëlqyeshëm në mbështetje të Shtabit të Bat. 3-të, si në planifikim ashtu edhe në ekzekutim, gjithashtu i pazëvendësueshëm ka qenë kontributi në nivel të njësive manovruese.Në 10 ditë sa ka zgjat ushtrimi fushor, gjatë operacioneve, kanë ndodhur mbi 30 incidente të cilat kanë qenë të llojeve të ndryshme, zakonisht të bazuara në skenarë realë dhe të përzgjedhura më shumë kujdes nga drejtori i ushtrimit, ku secili incident është menaxhuar sipas Procedurave të Vendimmarrjes Ushtarake në nivel batalioni, nivel kompanie dhe më ulët, në bazë të Proceduarave të Udhëheqjes së Trupave, që nënkupton së për menaxhimin e situatave të tilla janë përdorur proceduarat dhe standardet më të larta ushtarake të planifikimit dhe ekzekutimit. E gjithë kjo ka rezultuar me suksesin e treguara në terren.Për fund , nënkolonel Arsim Shaqiri, tha: "Secili ushtrim i ka karakteristikat dhe specifikat e veta siç janë: terreni, pjesëmarrësit, kushtet klimatike dhe kohëzgjatja, që janë pesë karakteristikat themelore që bëjnë të dallohet secili ushtrim. Duke i pas parasysh këta faktorë, pa marrë parasysh se sa kemi përvojë në ushtrime të tilla, qasja jonë duhet të jetë e tillë sikurse në po e realizojmë këtë ushtrim për herë të parë, por nënkuptohet se përvoja jonë në udhëheqjen e operacioneve me ndikim të lartë është një lehtësim, kështu që jam mjaft i kënaqur me udhëheqjen, bashkëpunimin dhe realizimin e këtij ushtrimi fushor. Ne do angazhohemi edhe më tej në ngritjen e profesionalizmit, duke nxjerrë mësimet e mësuara dhe implementimin e tyre për operacionet e ardhshme të FSK-së.

Nënkolonel Mehmet Lladrovci:

FSK-ja me sukses realizoi ushtrimin fushor "Shqiponja 2"

Ushtrimi fushor "Shqiponja 2" ka qenë mjaft sfidues, duke marrë parasysh së pjesëtarët e FSK-së deri në arritjen e Kapaciteteve Operacionale kanë ushtruar detyra të kapaciteteve fillestare në lëmin e emergjencave civile si zjarrfikje, MKAB dhe detyra të tjera. Në këtë ushtrim fushor, ata treguan përgatitjet e tyre profesionale të cilat i kishin arritur gjatë trajnimeve të shumta në bashkëpunim me Gardën Kombëtare të Ajovës, si dhe nga trajnimet tjera kolektive që janë zhvilluar në periudhën kohore nga arritja e kapaciteteve fillestare operacionale.

Gjatë tërë ushtrimit është parë se ushtarakët janë ndier të motivuar dhe me moral të lartë, gjë e cila tregon që pjesëtarët janë të trajnuar mirë, profesionist dhe po ashtu janë të gatshëm të përmbushin misionin në çdo katastrofë që i kanoset vendit tonë.

Udhëheqësi i Bazës së Përparme Operative, nënkolonel Mehmet



Lladrovci, gjatë këtij ushtrimi ka menaxhuar me mbi 320 pjesëtarë, me njësi të bashkangjitura të FSK-së, si (BAT2 RSH, RMC, BMO, KDS, PFK, NJNRK, KK) dhe mbi 30 incidente me skenarë të ndryshëm me fokusim kryesor mbrojtja e rrugëve të marshit (konvojit), patrullimet, pikat e kontrollit, ndërtimi i kampit, lëvizja e njësive në terren, reagimi në kontakt, paraqitja e grupeve të keqbërësve, kërkim-shpëtim, MKAB, deminim etj.

Sipas, nënkolonel Mehmet Lladrovcit, udhëheqja e këtij ushtrimi sa ishte atraktive po aq ishte edhe sfiduese, mirëpo ai tregon se falë një planifikimi, organizimi dhe komunikimi i cili ka qenë në nivelin më të lartë profesional kemi arritur që së bashku më pjesëtarët në vartësi ta realizojmë këtë ushtrim dhe jemi mjaft të kënaqur me të arriturat. "Parimisht jemi të kënaqur me planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve të përgjithshme në këtë ushtrim. Njëherësh vlerësojmë se ushtrimi fushor, "Shqiponja 2" ka qenë i nivelit më të lartë të demonstrimit të kapaciteteve tona në BPO".

Gjithashtu, Lladrovci u shpreh i kënaqur edhe me komentet e Ekipit Këshillues të Ushtrisë amerikane, i cili gjatë gjithë kohës ka qenë në përcjellje të ushtrimit, ku vazhdimisht kanë dhënë komente pozitive për realizimin e ushtrimit.





FSK-ja angazhohet në kërkim e një personi të zhdukur në Komunën e Mitrovicës

Njësia e Kërkim Shpëtimit (KSH) të Regjimentit të Mbrojtjes Civile(RMC), të FSK-së, u angazhua në operacion për kërkimin e personit K.M (58 vjeçar), nga Kqiqi i Madh i Komunë së Mitrovicës, që konsiderohet i zhdukur. Operacioni ka filluar më datë: 22 tetor 2013 dhe po vazhdon edhe më 23 tetor 2013, në një lokacion të gjerë që përfshin fshatin Kqiqin e Madh dhe fshatrat përreth tij.

Angazhimi i FSK-së në këtë operacion është bërë me vendim të zëvendësministrit të FSK-së, Muhamet Latifi dhe me urdhër të Komandantit të FSK-së, gjeneral-lejtënant Kadri Kastrati, pas kërkesës të Qendrës së Situatave të Qeverisë së Kosovës. Operacioni i kërkim-shpëtimin është përqendruar në kërkim në ujëra dhe kërkim në male.

12 kadetë certifikohen në Kursit, Reaguesit e Parë

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve të Kursit Reaguesit e parë-trajno-trajnerët. Kursin, Trajno-trajnerët e kanë kryer dymbëdhjetë pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së, kursin e kanë mbajtur instruktorë të Ushtrisë Amerikane, të Kampit, në Bonstill.

Në ceremoninë e certifikimit, morën pjesë: komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, (KFT) gjeneralmajori Rrahman Rama, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, (KDS) gjeneralbrigade Enver Cikaqi, komandanti i Kampit në Bonstill, koloneli David WOODS, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, të KFOR-it Amerikan, si dhe përfaqësues të NATO-s.



FORCA JONË

Gati! Me Forcën përpara!

Viti i II • Nr. 19 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

DITA E FORCËS

Viti i Kapaciteteve të Plota Operacionale të FSK-së



Prishtinë, 27 nëntor 2013

Përmbajtja

Viti i Kapaciteteve të Plota Operacionale të FSK-së 3
Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur Kapacitetet e Plota Operacionale 4
Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, përgëzoi ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FSK-së për KPO....5
Forca e Sigurisë së Kosovës më e besueshmja për qytetarët e Kosovës 6
FSK-ja parakalon në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" 6
Paradë dinjitoze e FSK-së në 5-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës 7
FSK-ja shënoi 15 vjetorin e manifestimit "Epopeja e UÇK-së" 7
Ministria për FSK-në dhe Ministria e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë nënshkruajnë Marrëveshjen "SOFA"....8
FSK-ja në stërvitjen rajonale "Joint Reaction 2013"në Shqipëri 8
FSK-ja në stërvitje të përbashkëta me ushtritë e vendeve të rajonit "Shared Resilience 13" në Republikën e Maqedonisë...9
Kadetët e FSK-së në stërvitjen rajonale " Kampi veror 13" në Krivollak 9
FSK-ja demonstroi nivel të lartë profesionalizmi në Ushtrimin Fushor "Shqiponja 2"....10
Koncert festiv për Vitin e Ri 11
FSK-ja me sukse të mëdha në fushën e deminimit 12
Ddemolimi i bombës 500 kilogramëshe 12
FSK-ja me kontingjentin e Ushtrisë Suedeze pastrojnë Gërminë 12
FSK-ja ngriti urën mobile mbi lumin Drini i Bardhë 13
FSK-ja është e përgatitur profesionalisht për ndërtimin e urave 13
Komandanti i Gardës Kombëtare të Aiovës, gjenerali Orr, vizitoi urën në Kramovik 14
FSK-ja përuroi urën afër Manastirit të Deçanit 14
FSK-ja ndihmoi qytetarët e Klinës pas përmbytjeve 15
FSK-ja dhuroi gjak për qytetarët e Kosovës 15
Fushatë e gjerë për vetëdijesimin nga minat 15
Në "Ditën e Tokës" fidane në fshatin Malishevë të Gjilanit 16
Nga radhët e minoriteteve edhe 30 pjesëtarë të rinj në FSK 16
Shkallë e lartë e respektimit të të drejtave të njeriut në MFSK-FSK 17
Diplomuan dhe u graduan kadetët e FSK-së të gjeneratës së pestë 17
Konferenca e 6-të Rajonale e Kampit Euro-Atlantik "REACT" 2013 18
Konferenca rajonale "Sfidat e Sigurisë të Adriatikut dhe Jonit" në Tiranë 18
Konferenca" SHBA-Karta e Adriatikut" në Slloveni 18
Ministri Çeku në ceremoninë e ndërrimit të Komandës së NATO-s në Gjermani 18
Ministri Agim Çeku takime me personalitet e NATO-s në Bruksel 19
Konferenca e ministrave të Mbrojtjes - Karta e Adriatikut – Ohër 19
Ministri dhe komandanti i FSK-së në stërvitjen "Luani Shqiptar 2013" 19
Ministri Agim Çeku dhe gjeneral Rrahman Rama në Senatin e Shtetit të Ajovës 19
Për Merita të Veçanta, gjeneral Kastrati nderohet me medalje nga Garda Kombëtare e Aiovës 20
Gjeneralmajor Rrahman Rama në Konferencën Ndërkombëtare të Fuqisë Ajrore dhe Hapësinore në Turqi 20
Marrëveshje Bashkëpunimi mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë 21
Memorandum Mirëkuptimi mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Suedisë 21
Qendra e Ekselencës Rajonale e Kërkim-Shpëtimit 21
Trajnim i suksesshëm i njësisë së MKABK-së në Montana të Bullgarisë 21
Promovimi i broshurave 22
Marshimi i FSK-së në Holandë 22

FORCA JONË

Gati! Me Forcën përpara! Viti i II • Nr. 19 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti i II •Nr. 19 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun,
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë

Adresa elektronike: informimi.mfsk@gmail.com, informimi.mfsk@rks-gov.net

Tel: 038/551-379

www.mksf-ks.org

Editoriali

Viti i Kapaciteteve të Plota Operacionale të FSK-së



Viti 2013 është vit i vazhdimësisë së sukseseve dhe ngritjes së FSK-së. Gjat këtij viti FSK-ja vazhdoi me aktivitetin e vet të planifikuar në arritjen e objektivave në kuadër të misionit, duke rritë shkallën e gatishmërisë dhe profesionalizmit në të gjitha drejtimet dhe sektorët. Në vitin e katërt të themelimit të FSK-së nga Selia e NATO-s u bë pranimi i Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO) të FSK-së. Ky akt i pranimit ishte vlerësim dhe certifikim i kapaciteteve operacionale të FSK-së. U mbajt ushtrimi fushor kompleks "Shqiponja 2" në territor të gjerë të vendit, duke dëshmuar shkallë të lartë angazhimit, mobilizimit dhe disiplinës. Këtë vit u bë nënshkrimi marrëveshjes së bashkëpunimit ushtarak SOFA në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë. Në kuadër të zgjerimit dhe thellimit të bashkëpunimit me partnerë të jashtëm u realizuan vizita të shumta të shefave të shtabeve dhe ministrave të mbrojtjes. Duke përfshi një numër të madh të ushtarëve nënoficerëve dhe oficerëve janë bërë trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Nga matjet e opinionit publik FSK-ja u vlerësua më së larti si institucioni më i besueshëm. Në bashkëpunim të ngushtë me popullatën civile, përmes Bashkëpunimit Civil-Ushtarak (BCU), në të mirë të komunitetit u realizuan shumë vepra dhe punë ingjiinjerike nga më të ndryshmet.


Angazhimi i përhershëm i MFSK-së dhe FSK-së ishte respektimi i drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore sipas standardeve më të avancuara, me cka u arrit nivel i lartë dhe me tendencë ngritjeje. Po këtë vit me fushatë të veçantë u realizua rritja e numrit të aplikuesve të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe më të mirët prej tyre u pranuan në radhët e FSK-së. Nga ky nivel i arritjeve të tashme konkrete, padyshim se në vitin e ardhshëm FSK-në e presin sfida dhe suksese të reja.



Deklarimi i Kapaciteteve të Plota Operacionale - KPO-ve

Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur Kapacitetet e Plota Operacionale

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, deklari se "Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur kapacitetin e saj të plotë operacional dhe është plotësisht e aftë për kryerjen e detyrave të caktuara brenda mandatit të saj, sipas standardeve të përcaktuara nga NATO. I përgëzoj të gjithë anëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës për arritjen e këtij hapi. Falënderoj ushtarakët e KFOR-it për atë që kanë bërë në ndërtimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Misioni i Forcës së Sigurisë të Kosovës mbetet ai që ka qenë dhe më parë: Kryerja e operacioneve të mbrojtjes civile dhe ndihma e autoriteteve civile në përgjigje të katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera. Aleanca do të vazhdojë të ofrojë mbështetje dhe këshilla nëpërmjet një ekipi ndërlidhës e këshillues të NATO-s. Misioni i KFOR-it mbetet gjithashtu i pandryshuar: Të sigurojë një mjedis të qetë e të sigurt për të gjithë njerëzit e komunitetet në Kosovë. Ne do të vazhdojmë ta përmbushim këtë mision në përputhje me mandatin tonë të Kombeve të Bashkuara. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor gjendet tek dialogu dhe pajtimi. Prandaj, inkurajoj pjesëtarët e të gjithë komuniteteve në Kosovë të marrin në konsideratë bashkimin me Forcën e Sigurisë të Kosovës, për të siguruar se ajo do të vazhdojë të bëhet një forcë e vërtetë shumetnike dhe përfaqësuese".





Me rastin e deklarimit të Kapaciteteve të Plota Oparecionale


Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, përgëzoi ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FSK-së

Të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të FSK-së,

Më 09 korrik 2013, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Anders Fogh Rasmussen, ka deklaruar se Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur Kapacitetet e Plota Operacionale dhe është plotësisht e aftë për kryerjen e detyrave të saj brenda mandatit që ka dhe standardeve të përcaktuara nga NATO.
Arritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale është një sukses i radhës i FSK-së, i arritur me përkushtimin, angazhimin, disiplinën dhe profesionalizmin e treguar nga të gjithë ju.
Andaj, ju përgëzoj dhe ju uroj për këtë sukses të deklaruar nga NATO.
Objektivi ynë kryesor është rrugëtimi drejt anëtarësimit në NATO dhe për të arritur këtë objektiv duhet të punojmë edhe më shumë në profesionalizimin e FSK-së.
Kërkoj nga ju, që të angazhoheni edhe në të ardhmen, që sa më shpejtë të arrijmë edhe objektivin tonë kryesor, që FSK të evoluojë në forcë ushtarake e cila do të jetë një faktor paqeje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, rajonin dhe më gjerë.

Urime dhe suksese!
Kadri Kastrati, Gjenerallejtënant





Forca e Siguris së Kosovës më e besueshmja për qytetarët e Kosovës

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka publikuar rezultatet preliminare të sondazhit "Barometri Kosovar i Sigurisë", për këtë vit, në vlerësimin e sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe politikës së jashtme. Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës ka dalë të jetë më e besueshmja. 72% e qytetarëve të Kosovës, sipas këtij sondazhi, janë shprehur të kënaqur me punën e Forcës së Sigurisë së Kosovës; 60 % e tyre janë të kënaqur me punën e KFOR-it ; 57% me punën e zjarrfikësve; 42 % me punën e Shërbimit Policor të Kosovës

Në 100- Vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë

FSK-ja parakalon në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit"

Në paradën e 100- vjetorit të krijimit të Shtetit Shqiptar, për herë të parë mori pjesë edhe një kuadrat i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), në përbërje prej 65 pjesëtarëve, ku prej tyre 11 ushtare. "Është një ndjesi shumë e mirë, është privilegj dhe nder të marrësh pjesë për 100-Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Për neve është një krenari shumë e madhe, mund të them krenaria më e madhe që unë kam përjetuar", është shprehur një prej anëtarëve të FSK-së. Kuadrati i FSK-së u vlerësua i suksesshëm dhe u pëlqye nga qytetarët.





Paradë dinjitoze e FSK-së në 5-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Në pesë vjetorin e Pavarësisë së Republikës të Kosovës, kuadratet e njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës së bashku me kuadratet e Policisë së Kosovës si dhe të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, parakaluan solemnisht në manifestimin qendror shtetëror, që u mbajt në sheshin "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti" në Prishtinë. Në manifestim morën pjesë personalite të larta shtetërore vendore dhe të shumë shteteve të botës.

FSK-ja shënoi 15 vjetorin "Epopesë së UÇK-së"

Në Kazermën "Adem Jashari" të FSK-së, u mbajt manifestimi me rastin e përvjetorit të 15-të të "Epopesë së UÇK-së". Me këtë rast u përkujtua dhe nderua Komandanti Legjendar Adem Jashari, Familja Jashari dhe të gjithë dëshmorët dhe martirët e kombit.





Ministria për FSK-në dhe Ministria e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë nënshkruajnë Marrëveshjen "SOFA"

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), Agim Çeku dhe Ministri i Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Arben Imami, në një akt solemn në qytetin e Prizrenit, kanë nënshkruar marrëveshjen ushtarake "SOFA". Marrëveshja"SOFA", rregullon procedurat e hyrjes/daljes, qëndrimit të përkohshëm dhe statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe anëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në territorin e shtetit përkatës, si dhe përbërësve civilë apo personave në varësi.

FSK-ja në stërvitjen rajonale "Joint Reaction 2013"në Shqipëri

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) përfundoi me sukses stërvitjet e përbashkëta të ushtrimit të koduar "Joint Reaction 2013" (Reagimi i Përbashkët 2013) me vendet e rajonit, të mbajtura në Zall-Herr të Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi "Joint Reaction 2013" ka filluar me 2 qershor dhe ka përfunduar më 7 qershor, përveç FSK-së, kanë marrë pjesë forcat ushtarake nga: Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi. Qëllimi kryesor i stërvitjes "Joint Reaction 2013" ka qenë rritja e ndërveprimit të forcave të përbashkëta, të krijimit të procedurave standarde të punës, bazuar në standardet e NATO-s, si dhe bashkëpunimi në fushat e tjera të sigurisë.





FSK-ja në stërvitje të përbashkëta me ushtritë e vendeve të rajonit “Shared Resilience 13” në Republikën e Maqedonisë

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) përfundoi me sukses stërvitjen kryesore në ushtrimin e përbashkët “Shared Resilience 13”, që u mbajt në Pepelishtë të Republikës së Maqedonisë, nga data 27 maj deri më 7 qershor 2013. Në këtë stërvitje morën pjesë kontingjentet e Sllovenisë, Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ushtrimi fushor “Shared Reseilence 13” u realizua duke u bazuar në skenarë të operacioneve për t'u përballur me fatkeqësi natyrore dhe ndihmë humanitare, nën përkujdesjen e NATO-s, Komandë së Bashkuar Amerikane për Evropë dhe Kombeve të Bashkuara (UN), në të cilin u demnostrua ndërveprimi i ushtrive dhe organizatave tjera në regjion.

Kadetët e FSK-së në stërvitjen rajonale “Kampi veror 13” në Krivollak

Kadetët e FSK-së, së bashku me përfaqësues të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Britanisë së Madhe, Malit të Zi, Maqedonisë dhe të Bullgarisë kanë marrë pjesë, për 10 ditë, në realizimin e ushtrimit të përbashkët, si një trup i vetëm, në poligonin ushtarak “Krivollak” të Maqedonisë. Objektiv i përgjithshëm i “Kampit veror 13'' ishte që të sjellë në praktikë, me anë të stërvitjeve, sfidat komplekse të operacioneve në konflikte dhe pas konflikteve, operacionet që kadetët pjesëmarrës-luftëtarë të ardhshëm të paqes mund të përballën.





FSK-ja demonstroi nivel të lartë profesionalizmi në Ushtrimin Fushor "Shqiponja 2"

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog dhe në terren, për 11 ditë, ka realizuar ushtrimin fushor "Shqiponja 2". Ushtrimi fushor ,,Shqiponja 2" është finalizim i suksesshëm i ciklit të stërvitjeve individuale dhe kolektive të FSK-së, për këtë vit. FSK-ja në realizimin e ushtrimit fushor, ka angazhuar 1951 pjesëtarë me 161 automjete. Ushtrimi ka filluar më 3 tetor dhe ka përfunduar më 8 nëntor dhe u zhvillua në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës, kryesisht në Regjionin e Pejës dhe Prizrenit. Qëllimi i ushtrimit fushor "Shqiponja 2" ishte që të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të njësive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren.





Koncert festiv për Vitin e Ri

Me rastin e festave të fund vitit, Orkestra Frymore e FSK-së, për herë të parë, ka dhënë një koncert festiv në Hotelin Emerald. Në koncert morën pjesë, ministri Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFOR-it, ambasadorë dhe atashe ushtarakë, oficerë të KFOR-it, të FSK-së, si dhe personalitete të tjera të jetës politike, artistike dhe kulturore të Kosovës.



FSK-ja me sukse të mëdha në fushën e deminimit


Kompania e Deminimit e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) është angazhuar maksimalisht në pastrimin e të gjitha fushave të minuara, me qëllim të krijimit të një mjedisi të sigurt në Kosovë.
Kompania e Deminimit ka angazhuar pesë ekipe në terren të shpërndara në : Gërmi, Luzhnicë, Kazermën në Ferizaj, Koshare dhe Harilaq. Gjatë këtij viti Kompania e Deminimit ka pastruar **107,752** metra katrorë, si dhe ka shkatërruar **204** mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera, ndërsa që nga fillimi i punës ka pastruar mbi 814.273 metra katrorë dhe ka shkatërruar 1939 mjete të pashpërthyera, si: mina, eksploziv, granata dore etj.
Përveç njësive që zhvillojnë operacionet e deminimit humanitar në terren, FSK-ja ka edhe dy njësi që kujdestarojnë 24 orë gjatë javës, për intervenime në rastet kur qytetaret hasin në mjete të ndryshme eksplozive dhe lajmërojnë për largimin e tyre. Këto ekipe kanë intervenuar në **366** raste dhe kanë demoluar **505** mjete të ndryshme eksplozive.

Demolimi i bombës 500 kilogramëshe

Deminerët e Kompanisë së FSK-së, së bashku me ata të KFOR-it amerikan, më 31 mars të këtij viti, në Harilaq (afër kodrës së Goleshit) kanë demoluar-shkatërruar me sukses një bombë të përmasave të mëdha mbi 500 kilogramëshe.

FSK-ja me kontingjentin e Ushtrisë Suedeze pastrojnë Gërminë

Kompania e Deminimit e FSK-së e ndihmuar edhe nga Regjimenti i Xhenios "Göta", i Forcave të Armatosura të Suedisë, me makineri të rëndë kanë pastruar rrënojat e një objekti në parkun "Gërmia"nëPrishtinë. Për këtë bashkëpunim dhe kontribut,në parkun e Gërmisë në Prishtinë është vendosur një pllakë përkujtuese si shenjë falënderimi, mirënjohjeje dhe bashkëpunimi në mes të FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Suedisë.



FSK-ja ngriti urën mobile mbi lumin Drini i Bardhë

Skuadra e urave e Batalionit të Xhenios e Brigadës Mbështetëse Operacionale të FSK-së, në një afat rekord ka ngritur urën mobile mbi Lumin Drini i Bardhë, që lidh aksin rrugor Klinë-Gjakovë. Ura është e gjatë 55 metra, e gjerë 5 metra, e rëndë 75 ton dhe mbanë peshën deri në 30 ton. Ngritjen e urës e kanë ndihmuar KFOR-i zviceran, Ministria e Infrastrukturës si dhe Komuna e Rahovecit dhe ajo e Gjakovës. Kjo urë është donacion nga KFOR-i austriak dhe është ngritur nga FSK-ja.

FSK-ja është e përgatitur profesionalisht për ndërtimin e urave

Oficeri i KFOR-it, OF2 Knupp Oliver JLSG HQ KFOR, specialist i ndërtimit të urave ka theksuar: "FSK-ja është e përgatitur profesionalisht për ngritjen e veprave të rëndësishme. Bashkëpunimi me pjesëtarët e FSK-së është shumë i mirë, madje shumë më i mirë se sa e kam menduar. Këta janë shumë të organizuar dhe të përgatitur profesionalisht për ngritjen e urave mobile. Në një kohë shumë të shkurtër kanë arritur ta montojnë urën mbi lumin Drini i Bardhë. Me gjithë se kam vetëm tetë muaj në Kosovë ,, jam i befasuar për të mirë, sepse këtu njerëzit janë shumë të mirë, janë human dhe mysafirët i presin me zemër hapur. Është një ndjenjë e mirë kur i sheh pjesëtarët e FSK-së se me çfarë profesionalizmi bëjnë ngritjen e urës. Gjatë dhjetë ditëve pune këtu nuk ka pasur as më të voglin problem".



Komandanti i Gardës Kombëtare të Aiovës, gjenerali Orr, vizitoi urën në Kramovik



Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT), gjeneralmajor Rrahmnan Rama së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Aiovës (SHBA), gjeneral major Timoty Orr, vizituan urën mbi lumin Drini i Bardhë, e cila u montua nga Njësiti i Xhenios i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BM0) i FSK-së.
Gjenerali Timoty Orr u shpreh se ndjehet tejet i lumtur që po sheh në terren vepra të xhenios së FSK-së, të cilat do t'u shërbejnë qytetarëve për lehtësimin e jetës së tyre. Ai tha se edhe Garda Kombëtare e Aiovës shpesh ftohet nga komuniteti për t'i mbështetur autoritetet civile, dhe se veprat e tilla janë në të mirë të të gjithë qytetarëve.

FSK-ja përuroi urën afër Manastirit të Deçanit

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht Batalioni i Xhenios (BXH) i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO), ka përfunduar punimet në ndërtimin e urës tip montazh, afër manastirit të Deçanit, në Komunën e Deçanit. Batalioni i Xhenios në bashkëpunim me KFOR-in (kontingjentin e Suedisë, Italisë, Danimarkës dhe atij të Francës), kanë qenë të angazhuar në këtë projekt, që nga data 2 deri më 20 shtator të këtij viti.





FSK-ja ndihmoi qytetarët e Klinës pas përmbytjeve

Ekipet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) pas vërshimeve-përmbytjeve, si pasojë e reshjeve të shiut, më 15 mars, përmes një operacioni të gjerë kanë bërë evakuimin e qytetarëve në shumë vendbanime të Kosovës e sidomos në komunën e Klinës, Pejës, Skenderajt dhe Mitrovicës.

FSK-ja dhuroi gjak për qytetarët e Kosovës



FSK-ja ka një traditë të organizimit dhe të dhurimit humanitar të gjakut. Ky është viti i pestë që FSK-ja po dhuron gjak. Pjesëtarët e FSK-së, jo vetëm gjatë organizimit të aksioneve të rregullta, por ata po dhurojnë gjak edhe jashtë këtyre organizimeve. Ata janë gjithmonë të gatshëm për dhurimin e gjakut edhe në rastet emergjente për nevojat e pacientëve.

Pjesëtarët e FSK-së, çdoherë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni dhe janë donatorë të rregullt të dhurimit të gjakut. FSK-ja, deri më tani ka dhurua mijëra doza gjak që janë përdorë në shërbim të gjithë atyre që kanë pasur nevojë për të.

Aksionin humanitar e kanë kryer infermieret e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK), në bashkëpunim me infermierët e Batalionit të Mjekësisë së FSK-së.



Fushatë e gjerë për vetëdijesimin nga minat

Qendra Koordinuese për Deminim në MFSK-së dhe Kompania e Deminimit, në bazë të planifikimit, kanë realizuar me sukses ligjëratat për vetëdijesimin e nxënësve nëpër shkollat fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës, për rrezikun nga mjetet e pashpërthyera siç janë: mina, eksploziv, granata dore etj.. Bazuar në planin e hartuar që më parë, Kompania e Deminimit e FSK-së, gjatë periudhës dimërore, ka mbajtur ligjërata në 18 komuna ku janë përfshirë 50 shkolla. Ligjëratat i kanë përcjellë më shumë se 2599 nxënës.



Në "Ditën e Tokës" fidane në fshatin Malishevë të Gjilanit

Ministri Agim Çeku, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral major Rrahman Rama, qëndruan sot në fshatin Malishevë të Komunës së Gjilanit, ku në mënyrë simbolike filluan aksionin e mbjelljes së fidanëve nga pjesëtarët e FSK-së me rastin e 22 Prillit, Ditës së Tokës.

Nga radhët e minoriteteve edhe 30 pjesëtarë të rinj në FSK

Këtë vit Forcës së Sigurisë së Kosovës i janë shtuar edhe 30 pjesëtarë të rinj, nga radhët e komuniteteve pakicë: 26 serbë, 2 boshnjak, 1 turk dhe 1 ashkali. Me pranimin e pjesëtarëve të rinj, nga radhët e komuniteteve, FSK-ja po realizon standardet e larta për barazi të komuniteteve.





Shkallë e lartë e respektimit të të drejtave të njeriut në MFSK-FSK

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) krahas ngritjes së kapaciteteve të plota operacionale, rëndësi të veçantë i kushton respektimit dhe avancimit të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, fakt që është dëshmuar në mënyrë të përhershme që nga themelimi i kësaj force.
Aktualisht në MFSK përqindja e femrave është 32%. Ndërsa përqindja e femrave në uniformë në MFSK/FSK është 8.23%, përkatësisht 188 femra në uniformë në gradën e oficerit dhe nënoficerit.

Diplomuan dhe u graduan kadetët e FSK-së të gjeneratës së pestë

Më 5 korrik, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj është mbajtur ceremonia e diplomimit të kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare (QSU) të FSK-së, gjenerata e pestë, viti 2013. QSU e FSK-së deri më tani ka shkolluar pesë gjenerata me kadet, të cilët me sukses po i bartin njohuritë e reja në të gjitha njësitë e FSK-së.



Konferenca e 6-të Rajonale e Kampit Euro-Atlantik "REACT" 2013

Ministri Çeku ka ligjëruar në Konferencën e 6-të Rajonale të Kampit Euro-Atlantik "REACT" me temën: "Republika e Kosovës në Marrëdhëniet Ndërkombëtare Bashkëkohore", i cili është mbajtur në qytetin e Plavës në Mal të Zi.



Konferenca rajonale "Sfidat e Sigurisë të Adriatikut dhe Jonit" në Tiranë

Ministri i Forcës së Sigurisë, Agim Çeku me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, ka marrë pjesë në konferencën "Sfidat e Sigurisë së Adriatikut dhe Jonit" (Adriatic and Ionian Security Challenges), që është mbajtur në Tiranë të Republikës së Shqipërisë nga data 28 deri më 30 maj 2013.

Konferenca" SHBA-Karta e Adriatikut" në Slloveni

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Agim Çeku, me ftesë të Ministrit të Mbrojtjes të Sllovenisë, z. Roman Jakiq, ka marrë pjesë në Konferencën, "SHBA Karta e Adriatikut-A5", (takim gjithëpërfshirës i ministrave të mbrojtjes të vendeve të rajonit), nga data 30 shtator deri më3 tetor 2013, që është mbajtur në qytetin e Bërdos në Slloveni.

Ministri Çeku në ceremoninë e ndërrimit të Komandës së NATO-s në Gjermani

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, me ftesë të komandantit Suprem të NATO-s Admiralit James Stavridis, në Shtutgart të Gjermanisë ka marrë pjesë në ceremoninë e ndërrimit të Komandës së NATO-s nga Admirali James Stavridis tek gjenerali Philip Breedlove.



Ministri Agim Çeku takime me personalitet e NATO-s në Bruksel

Delegacioni i Republikës së Kosovës i udhëhequr nga ministri i FSK-së Agim Çeku i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjatë qëndrimit në Bruksel kanë zhvilluar takime të rëndësishme në Selinë e NATO-s dhe të BE-së.

Konferenca e ministrave të Mbrojtjes - Karta e Adriatikut - Ohër

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku me ftesë të Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi kryesues i radhës, ka marrë pjesë në Konferencën e ministrave të mbrojtjes të vendeve të rajonit, "SHBA-Karta e Adriatikut", me temë "Së bashku drejt paqes dhe sigurisë globale" që është mbajtur në Ohër të Republikës së Maqedonisë, më 13 dhe 14 qershor 2013.

Ministri dhe komandanti i FSK-së në stërvitjen "Luani Shqiptar 2013"

Ministri i FSK-së Agim Çeku së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati ka marrë pjesë (në ditën e personave shumë të rëndësishëm) në ushtrimin "LUANI SHQIPTAR 2013" (Albanian Lion 2013). Ky ishte ushtrim i përbashkët i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Britanisë së Madhe. Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kanë qenë mysafirë nderi dhe njëherësh e kanë përcjellë nga afër ushtrimin e koduar "Luani Shqiptar 2013". Për të përcjellë ushtrimin e përbashkët kanë marrë pjesë personalitet më të larta të Shqipërisë, Britanisë së Madhe dhe të rajonit.

Ministri Agim Çeku dhe gjeneral Rrahman Rama në Senatin e Shtetit të Ajovës

Senati i Ajovës e ka shpallur Agim Çekun qytetar nderi, për kontributin e tij në forcimin e lidhjeve në mes të Kosovës dhe Ajovës. Ministri i FSK-së Agim Çeku, gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka zhvilluar takime të shumta me personalitetet më të larta të SHBA-s, në Pentagon dhe në Shtetin e Ajovës. (Me Shtetin e Ajovës dhe Gardën Kombëtare të Ajovës, është nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi mes Kosovës dhe MFSK-në).





Për Merita të Veçanta, komandant Kadri Kastrati nderohet me medalje nga Garda Kombëtare e Aiovës

Komandant i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, është nderuar me medalje për Merita të Veçanta nga Garda Kombëtare e Aiovës e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në emër të Gardës, medaljen gjeneral Kastratit, ia ka dorëzuar Adjutanti i Përgjithshëm i Gardës Kombëtare, gjeneralmajor Timoty Orr.

Gjeneralmajor Rrahman Rama në Konferencën Ndërkombëtare të Fuqisë Ajrore dhe Hapësinore në Turqi

Zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Rrahman Rama, me ftesë të komandantit të Forcave Ajrore të Turqisë, gjeneral Mehmet Erten (gjeneral me katër yje) ka marrë pjesë në Konferencën e Parë Ndërkombëtare për Fuqinë Ajrore dhe Hapësinore, që është mbajtur në Stamboll të Turqisë.





Marrëveshje Bashkëpunimi mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës Agim Çeku, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Sllovenisë, z.Jakiq, ka vizituar Slloveninë. Ministri Agim Çeku dhe ministri i Mbrojtjes së Sllovenisë Roman Jakiq kanë nënshkruar Marrëveshjen për Bashkëpunim në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në mes të dy ministrive, asaj të Sllovenisë dhe të Ministrisë së FSK-së.



Memorandum Mirëkuptimi mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Suedisë

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, (MFSK) më 4 prill është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të armatosura të Suedisë, për trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së dhe për operacionet e Deminimit në Kosovë.

Qendra e Ekselencës Rajonale e Kërkim-Shpëtimit

"Te Pishat", në fshatin Sllatinë e Madhe, Komuna e Fushë-Kosovës, u mbajt ushtrimi i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të FSK-së në kërkim-shpëtim urban.





Trajnim i suksesshëm i njësisë së MKABK-së në Montana të Bullgarisë

Një Tog i Kompanisë së Mbrojtjes Kimike-Atomike dhe Biologjike (MKAB) të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në përbërje prej 20 pjesëtarëve, ka qëndruar për një trajnim gjashtë javësh, në Qendrën Profesionale të Trajnimit të Drejtorisë së Përgjithshme pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në qytetin Montana të Republikës së Bullgarisë. Trajnimi i Togut të MKABK-së, në kursin "Lëndë të rrezikshme" ishte organizuar me ndihmën e Grupit për Mbrojtje Civile, pranë Komitetit për Planifikim Civil Emergjent të NATO-s. Trajnimi ishte i destinuar për ata që reagojnë të parët në raste të aksidenteve me lëndë të rrezikshme. Qëllimi i trajnimit ishte që pjesëmarrësit në trajnim të përfitojnë sa më shumë njohuri praktike për zvogëlimin e pasojave në raste aksidentesh me lëndë të rrezikshme.



Promovimi i broshurave

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka bërë prezantimin e dy broshurave: "Të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore në MFSK dhe FSK" dhe "Gratë në Forcën e Sigurisë së Kosovës". Broshurat janë botuar në gjuhën shqipe, serbokroate dhe atë angleze. Gjatë promovimit të këtyre broshurave u prezantua puna, aktiviteti dhe pozita e femrës në Ministri dhe FSK. Gjinia femërore në MFSK luan një rol të madh në ngritjen e besueshmeriswww së FSK-ë si në prezantimin me dinjitet të uniformës ashtu edhe të gjithë punës së këtij institucioni

Marshimi i FSK-së në Holandë

Për herë të tretë rresht kontingjenti i FSK-së është kthyer me sukses të plotë nga pjesëmarrja në marshimin tradicional që është mbajtur në Njimengen të Holandës., Kanë marrë pjesë ushtritë e 53 shteteve anëtare të NATO-s dhe të shteteve të tjera të botës.
Marshi ushtarak i Njimengenit daton që nga viti 1909 dhe është ngjarja më e madhe e këtij lloji në botë. Këtë vit, Marshimi tradicional është mbajtur nga data 14-21 korrik 2013. Kontingjenti i FSK-së është përfaqësuar me 30 pjesëtarë, në mesin e tyre kanë marrë pjesë edhe 4 pjesëtare të FSK-së. Edhe këtë vit kontingjenti i FSK-së e arriti suksesin e viteve të kaluara, duke arritur që të gjithë pjesëtarët e kontingjentit të kalojnë shtegun prej 160 km.







www.mksf-rks.org

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 20 • Shkurt 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Vizita e ministres së Mbrojtjes së Shqipërisë znj. Mimi Kodheli në FSK

Thellohet bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë

Në ambientet e Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës, më 10 janar 2014, qëndroi për një vizitë zyrtare ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, e cila u prit me nderime të larta nga Togu i Nderit dhe Orkestra Frymore e FSK-së.



Ministrja Kodheli fillimisht është pritur në një takim të veçantë nga ministri Agim Çeku, i cili pasi i uroi mirëseardhje në FSK, vlerësoi lartë punën e saj dhe të delegacionit që ajo kryeson. Më pastaj të dy delegacionet vazhduan takimin në nivel të zgjeruar.

Përveç ministrit Çeku në takim ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët: Zymer Halimi, Bashkim Jashari, Gëzim Hazrolli dhe Enver Cikaqi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së z. Shkëlzen Sylaj dhe kolonel Hasan Hoxha, ushtrues i detyrës së drejtorit në Departamentin për Siguri dhe Bashkëpunim. Ndërsa pjesë e delegacionit të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, ishin: Islam Lauka, ambasador i Shqipërisë në Kosovë, Gjergj Teneqexhiu, drejtor i kabinetit, Edlira Prendi, këshilltare për shtyp, Arian Zaimi, këshilltar ushtarak dhe kolonel Fiqri Hoxha, atashe ushtarak.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, pasi që i dëshiroi mirëseardhje dhe e uroi ministren Kodheli për detyrën e re, falënderoi atë dhe Ministrinë e Mbrojtjes për ndihmat që kanë dhënë dhe po japin për FSK-në. Ministri Çeku gjatë takimit e ka njoftuar gjerësisht ministren e Mbrojtjes znj. Kodheli për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, shkollimin, trajnimet, bashkëpunimin, planin e zhvillimit në të ardhmen si dhe për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë. Pas takimit të dy ministrat mbajtën një konferencë të përbashkët me gazetarë.

Me këtë rast, ministri i MFSK-së, Agim Çeku, tha se FSK-ja është një tregim i suksesshëm në Kosovë, është institucioni më i besuar nga qytetarët e Kosovës, është institucion i afirmuar, profesional, kredibil, i trajtuar si partner nga faktori ndërkombëtar dhe thjeshtë është edhe i pranuar edhe nga ana e NATO-s, si një institucion që ka ngritur të gjitha kapacitetet e veta."Të gjitha sukseset që kemi arritur, një pjesë të rëndësishme të kontributit ka edhe Shqipëria dhe Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, që na kanë ndihmuar, që ne sot, të deklarojmë që jemi institucion i suksesshëm", tha ai. Në takim të dy ministrat diskutuan edhe për projekte konkrete në të ardhmen.

Ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Kodheli, falënderoi ministrin Çeku dhe shtoi se kjo vizitë është një kënaqësi e veçantë për të. "Unë në të njëjtën kohë e informova ministrin Çeku për të gjitha zhvillimet e fundit të Forcave tona të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Nga ana e saj, ministrja Kodheli nënvizoi se bashkëpunimi në mes dy vendeve tona do të intensifikohet akoma më tej, dhe oguri më i mirë është mbledhja e përbashkët e dy qeverive.

Në fund, ministrja Kodheli shtoi se me ministrin Çeku ndamë mendimin e njëjtë për nivelin e bashkëpunimit që kemi midis FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ne të dy palët do të gjejmë rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit më të lartë. Ne jemi këtu për ta mbështetur këtë proces në mënyrë që me ndihmën e aleatëve tanë strategjikë dhe të SHBA-s, Shqipëria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën dhe FSK-në drejt integrimit në NATO dhe Bashkim Evropian.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, u prit në takime të veçanta edhe nga presidentja e Kosovës, Znj. Atifete Jahjaga, kryetari i Parlamentarit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi dhe kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi. Gjatë takimit u biseduan edhe tema të përgjithshme, si angazhimi i përbashkët me qëllim të intensifikimit të marrëdhënieve të shkëlqyeshme midis dy vendeve. Ministrja Kodheli, nga ana e saj, shprehu gatishmërinë e Qeverisë së Shqipërisë për të ndihmuar në përfshirjen e Kosovës në iniciativat rajonale dhe ato ndërkombëtare të sigurisë, si dhe për shkëmbim të përvojave në procesin e integrimit të Kosovës në NATO.

Gjeneral Kastrati përcolli trajnimet për Menaxhimin e Emergjencave dhe Operacionet Paqësore



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku më zëvendës komandantin e Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrollin, më 29 janar, përcollën nga afër trajnimet e pjesëtarëve të FSK-së në Menaxhimin e Emergjencave dhe Operacionet Paqësore, të cilat po mbahen në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore në Prishtinë.

Trajnimet për Menaxhimin e Emergjencave" dhe "Operacione Paqësore", që kanë filluar të mbahen gjatë kësaj jave, janë si rezultat i një bashkëpunimi të mirë që FSK-ja ka me Gardën Kombëtare të IOWA-s (SHBA) dhe me Armatën e Turqisë. Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati fillimisht ka falënderuar ekipet e instruktorëve të Gardës Kombëtare të IOWA-s dhe të Armatës së Turqisë, për mbështetjen e tyre të vazhdueshme përmes trajnimeve të ndryshme si kolektive ashtu edhe individuale, me qëllim që FSK-ja të jetë e gatshme në aspektin profesional të përballet me çdo lloj situate emergjente. Gjeneral Kastrati, nga pjesëmarrësit e trajnimeve, kërkoi që njohuritë e fituara t'i bartin me sukses te njësitet e tyre, për të shtuar: "Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur që më punën, angazhimin dhe seriozitetin e tyre të jenë institucioni më i besueshëm në vend. E gjithë kjo nuk do të kishte ndodhur pa mbështetjen e vazhdueshme të miqve tanë". Ndërsa, udhëheqësit e ekipeve trajnuese falënderuan gjeneral Kastratin për vizitën dhe përkushtimin e tij, për bashkëpunimin e mirë si dhe premtuan realizim të trajnimeve më të avancuara për Forcën e Sigurisë të Kosovës.

Ministri i FSK-së Agim Çeku takoi ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar Ian Cliff

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Agim Çeku, më 28 janar, priti ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Ian Cliff. Ministri Çeku falënderoi ambasadorin për ndihmën e çmuar të Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën dhe në veçanti për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ai e njoftoi ambasadorin Cliff me zhvillimin e përgjithshëm të FSK-së dhe me punën që po bëhet rreth Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Kosovës. Ndërsa, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, z. Ian Cliff, premtoi se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe ndërmjet dy institucioneve do të thellohen edhe në të ardhmen.



Vlerësime për arritjet e FSK-së gjatë vitit 2013 marrë nga gazeta ditore "Epoka e Re"

Viti 2013 i veçantë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti 2014 pritet të jetë vit kur FSK-ja duhet të shndërrohet në Ushtri të Kosovës. Ky është konstatimi i përbashkët i Qeverisë së Kosovës, opozitës dhe ekspertëve të sigurisë. Udhëheqësit e FSK-së dhe anëtarët e komisionit parlamentar për mbikëqyrjen e kësaj force e kanë vlerësuar të jashtëzakonshme performancën e FSK-së në vitin 2013. Sipas tyre, kjo forcë është institucioni më kredibil në Republikën e Kosovës. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) edhe këtë vit ka renditur sukseset e saj në përputhje me misionin që ka pasur. E arritura më e madhe për këtë forcë ka qenë plotësimi i kapaciteteve operacionale, të cilat u deklaruan nga Këshilli Veri-Atlantik i NATO-s në muajin korrik. Edhe në vitin 2013 FSK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besueshëm nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Madje kjo forcë përbën institucionin e vetëm që i bashkon pozitën e opozitën. Të gjithë, përfshirë opozitën dhe njohësit e çështjeve të sigurisë, janë të mendimit se tani ka ardhur koha që kësaj force t'i ndryshohen emri, struktura, misioni dhe të ngarkohet me detyra që kanë të gjitha ushtritë e shteteve demokratike.



Ministri Agim Ceku: Viti 2013, vit i kapaciteteve operacionale

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Agim Çeku, duke e vlerësuar arritje të jashtëzakonshme plotësimin e kapaciteteve, ka thënë për "Epokën e re" se tanimë kjo forcë nuk është në mbikëqyrje të KFOR-it, por në raporte partneriteti. "Padyshim se edhe viti 2013 ka qenë vit i suksesshëm për FSK-në, e cila ka arritur një fazë të sukseseve edhe këtë vit. Mendoj se ngjarja e vitit sa i përket FSK-së është deklarimi i kapaciteteve të plota operacionale nga ana e NATO-s. Pra, vendimi i NATO-s, që ta vazhdojë mbështetjen e FSK-së, duke e themeluar një trup të ri të quajtur Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, krahas ekipit këshillues të NATO-s që është në ministri", ka thënë Çeku. Të arritur tjetër ai ka përmendur rolin aktiv dhe konstruktiv që kjo forcë po luan në rajon, duke u respektuar gjithnjë e më shumë nga forcat ushtarake të rajonit si partnere e denjë nëpër konferenca dhe ushtrime të ndryshme stërvitore. Sipas Çekut, në të gjitha këto aktivitete FSK-ja është dalluar për të mirë nga forcat e tjera të rajonit. Çeku ka shtuar se FSK-ja po e përfundon rishikimin e vet në kuadër të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe është në fund të përmbylljes së procesit për të definuar të ardhmen e vet si forcë ushtarake në Kosovë. "FSK-ja është në përmbyllje të rishikimit, në përmbyllje të definimit të disa të gjeturave nga ky studim dhe në fillim të vitit 2014 do t'ia rekomandojë Qeverisë dhe Këshillit Nacional të Sigurisë se çfarë misioni duhet të ketë, çfarë emri, çfarë strukture dhe çfarë detyra. Krejt kjo do të jetë në përputhje me ato detyra që forcat ushtarake i kanë në çdo vend të pavarur dhe demokratik", ka thënë ministri Çeku. Ai ka treguar se edhe këtë vit FSK-ja është dëshmuar se është forcë në të mirë të gjithë qytetarëve të Kosovës, duke i ndihmuar ata në realizimin e shumë projekteve.



Gjeneral Kastrati: FSK-ja në shërbim të gjithë qytetarëve

Pothuajse vlerësime të njëjta ka pasur edhe komandanti i kësaj force, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili ka deklaruar për gazetën se viti 2013 ishte vit i realizimit të objektivave, prioriteteve dhe arritjeve të shumta. "Ky vit është vit i plotësimit të kapaciteteve operacionale, të cilat u deklaruan nga Këshilli Veri-Atlantik i (NATO-s) në korrik të këtij viti, me ç'rast edhe formalisht u vlerësua puna dhe angazhimi i pjesëtarëve dhe lidershipit të FSK-së në ngritjen dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve thelbësore për realizim të misionit. Gjithashtu, edhe gjatë këtij viti prioritet imi ishte ngritja profesionale e pjesëtarëve të FSK-së", ka thënë Kastrati, duke shtuar se shumë pjesëtarë kanë kryer dhe po vazhdojnë të kryejnë stërvitje, trajnime dhe shkollime brenda dhe jashtë vendit, nëpër akademitë më prestigjioze të vendeve si SHBA, Turqi, Mbretëri të Bashkuar, Gjermani, Kroaci, Holandë, Maqedoni etj. Ai ka treguar se kjo forcë me përgjegjësi të lartë ka vazhduar t'i kryejë operacionet e çminimit, kërkim-shpëtimit, inspektimit të kompanive shtetërore dhe private për rrezikshmëri nga materiet e rrezikshme, vlerësimit të vazhdueshëm të kërcënimeve të mundshme nëpër komunat e vendit. "FSK-ja ka qëndruar afër qytetarëve, komuniteteve, institucioneve dhe organizatave joqeveritare duke i mbështetur ato me projekte të ndryshme humanitare. Ndërtimi dhe meremetimi i rrugëve, urave, shtëpive, pastrimi dhe thellimi i lumenjve dhe zonave të rrezikshme, përkrahja mjekësore e banorëve nga radhët e komunitetit serb etj. ishin prioritetet tona edhe këtë vit", është shprehur Kastrati.

Edhe opozita krenare me FSK-në



Kryetari i këtij komisioni, Ahmet Isufi, ka thënë për "Epokën e re" se FSK-ja është institucioni më kredibil në Kosovë. "FSK-ja ka realizuar objektivat e veta sa iu përket ngritjeve profesionale. Pra, kjo forcë ka treguar performancë të jashtëzakonshme sa i përket opinionit, duke qenë në shërbim të popullit të Kosovës. FSK-ja është institucioni më kredibil në Kosovë dhe me këtë mburremi. E vetmja gjë që ka mbetur pa realizuar është emri i merituar i kësaj force që është Ushtri e Kosovës", ka thënë Isufi, duke shtuar se me krijimin një politike ofensive dhe me një bashkëpunim shumë më energjik me strukturat e NATO-s do ta mundësonte edhe realizmin e këtij objektivi.



Edhe deputeti i LDK-së në këtë komision, Anton Çuni, ka thënë se ky institucion është më i vlerësuari edhe nga strukturat ndërkombëtare. "FSK-ja është një ndër institucionet që, sipas të gjitha vlerësimeve të autoriteteve ndërkombëtare, ka marrë nota të larta në përmbushjen e misionit dhe në performacën e saj. Po ashtu, kemi pasur rast që FSK-në ta shohim edhe në veprimet konkrete, kur ka pasur nevojë të zbarkojë jashtë vendit siç ishte rastin në Shqipëri apo dhe brenda Kosovës, sidomos në rastet e kërkim-shpëtimit", ka deklaruar Çuni për "Epokën e re", duke shtuar se edhe sondazhet e organizatave joqeveritare të bëra me qytetarët e kanë nxjerrë FSK-në si institucionin me prestigjin më të lartë në Kosovë. Ai ka vlerësuar se institucionet vendore në bashkëpunim me ato ndërkombëtare duhet ta caktojnë mandatin e ardhshëm të kësaj force. "Kjo varet nga vlerësimi i pranisë ushtarake ndërkombëtare, në këtë rast nga KFOR-i dhe NATO, në bashkëpunim me institucionet e vendit që të japin një mendim se çka të bëhet më tutje me FSK-në. Ne si anëtarë të komisionit jemi në dijeni se është formuar një grup punues për rishikimin strategjik të sigurisë dhe jam i bindur se në vitin 2014 ky grup do të dalë me rezultatet e punës se si e shohin organizimin e gjithë institucioneve të sigurisë", ka deklaruar ai.



Ndërsa deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje!, Rexhep Selimi, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës që FSK-në nuk e ka shndërruar në Ushtri të Kosovës. "Sikur jo rrallëherë, edhe kësaj radhe doli që FSK-ja jo vetëm se nuk u bë ushtri, por vetë fjala apo termi ushtri u zhduk nga fjalori i atij që e kishte paralajmëruar këtë gjë. Pra, vetë ministri që e kishte proklamuar se FSK-ja do të bëhej ushtri, i njëjti e hoqi nga fjalori fjalën ushtri", ka thënë Selimi për "Epokën e re". Sipas tij, është e palogjikshme të flitet për integrimet euroatlantike dhe të mos bëhet FSK-ja ushtri e Kosovës. "Le të kujtojmë edhe një herë se është joreale dhe hipokrite të flasim për integrimin në NATO nëse njëkohësisht na mungon institucioni mbi të cilin duhej ta mbështesnim anëtarësimin në NATO. Pra, nuk mund të kërkojmë të marrim pjesë nga barra e NATO-s nëse nuk kemi ushtri", ka thënë ai, duke shtuar se Kosova ka nevojë për ushtrinë e saj ashtu siç i kanë të gjitha shtetet e rajonit. Sipas tij, Ushtria e Kosovës do t'i jepte kuptim edhe vetë shtetit të Kosovës.



Ndërsa, njohësi i çështjeve të sigurisë, Naim Maloku, kritikat se pse FSK-ja nuk është bërë ushtri deri më tani i ka quajtur të paarsyeshme. "FSK-ja i ka arritur objektivat që i ka pasur me ligj. Mirëpo edhe kjo forcë është e kushtëzuar edhe prej vlerësimeve të NATO-s dhe pa marrë miratimin e NATO-s, FSK-ja nuk mund të ngritët në detyra dhe obligime e përgjegjësi të tjera jashtë ligjit që i përcaktohen", ka thënë Maloku. Maloku është shprehur i kënaqur me dinamikën e zhvillimit të FSK-së. Ai ka thënë për gazetën se tash, pas arritjeve të objektivave që kanë qenë të përcaktuara me ligj, duhet t`i hapet rrugë kësaj force që të ngritët në ushtri. "Meqë FSK-ja i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe objektivat që i ka pasur të përcaktuara me ligjin për FSK-në dhe me Kushtetutën e Kosovës, duhet që Ligjin për FSK-në Kuvendi i Kosovës ta ndryshojë dhe duhet t'i jepen objektivat e tjera të cilat do t'i mundësojnë kësaj force të zhvillohet me një dinamikë tjetër dhe me u ngrit në ushtri", ka thënë Maloku.

Grupi për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë më së largu deri në shkurt të vitit 2014 do ta prezantojë studimin lidhur me arkitekturën e sigurisë që i duhet Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij procesi gjithëpërfshirës është edhe rishikimi i FSK-së. Ky grup do t'i rekomandojë Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe Këshillit Nacional të Sigurisë se çfarë misioni, emri apo strukture do të ketë FSK-ja në vitin 2014.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Intervistë e marrë nga gazeta "Sioux City Journal" - SHBA

Koloneli Steve Warnstadt: "Shqiptarët më pro amerikanë se vetë amerikanët"

Koloneli amerikan Steve Warnstadt, ish-ligjdhënësi i Shtetit të Iowas, i cili shërbeu si këshilltar i NATO-s në Forcën e Sigurisë së Kosovës, pas qëndrimit të tij njëvjeçar në Kosovë ka krijuar përshtypjen se populli dhe Qeveria e Kosovës janë jashtëzakonisht pro amerikanë.

"Në sondazhet e parvjetshme të Gallup-it, në mbi 100 vende rreth mbështetjes së politikave amerikane, Kosova ka një vlerësim të aprovimit 88 për qind të këtyre politikave.

Është ky një nivel i mbështetjes që sigurisht duhet të jetë më i lartë se sa në mesin e amerikanëve", thotë Warnstadt dhe nënvizon se "është një gjë e zakonshme të vëzhgosh flamurin amerikan të valojë po aq shpesh sa edhe flamuri i Kosovës".

Ai këtu përmend bulevardin "Bill Clinton", dyqanin "Hillary," rrugën "Bob Dole", rrugën tjetër "George W. Bush", emrat e rrugëve dhe shesheve, Madeline Albright dhe



Wesley Clark etj.

Koloneli Warnstadt më tej shkruan se Garda Kombëtare e Iowa-s dhe FSK-ja e Kosovës janë të lidhura në Programin e Partneritetit Shtetëror të Gardës Kombëtare, një program i hartuar në fund të "Luftës së Ftohtë" për të ndihmuar vendet e Evropës Lindore, gjatë kalimit në demokraci.

"Partneriteti Iowa-s është i veçantë, sepse ai po ndihmon Kosovën për të ndërtuar profesionalizimin e forcave të saja të sigurisë dhe është i njohur si një nga programet më aktive dhe më të fuqishme të partneriteteve shtetërore".

Koloneli Steve Warnstadt thekson më tej: "Kosova përballet me një numër sfidash ku të ardhurat për kokë banori janë më të ulëtat në Evropë; ku vendi ka moshën më të re mesatare dhe një nga shkallët më të larta të papunësisë. Mungesa e perspektivës ka ndikuar që shumë të rinj të largohen duke i krijuar mungesën e disa prej talenteve të saj më të mirë".

"Përkundër këtyre vështirësive, shumica e kosovarëve janë optimistë për të ardhmen dhe i shikojnë Shtetet e Bashkuara si një model në përballjen me sfidat e tyre", shkruan ndër të tjera në gazetën "Sioux City Journal", koloneli Steve Warnstadt.

Ministri Agim Çeku takoi ambasadorin e ri të Maqedonisë Ilija Strashevskin

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Agim Çeku, më 16 janar, priti në një takim njohës ambasadorin e ri të Republikës së Maqedonisë në Kosovë, z.Ilija Strashevski.

Fillimisht ministri Çeku, ambasadorit të Maqedonisë i uroi detyrën e re në Kosovë dhe më pastaj e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe për bashkëpunimin e mirë në mes dy ministrive; Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë dhe Ministrisë së FSK-së.

Ndërsa, ambasadori i sapoemëruar i Republikës së Maqedonisë në Kosovë, z. Ilija Strashevski falënderoi ministrinë Çeku për pritjen dhe premtoi se do të angazhohet me gjithë kapacitetin që marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe dy institucioneve të thellohen edhe më tej në të ardhmen.





Gjeneralmajor Rrahman Rama para studentëve të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti"

Zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e përgjithshme shkollore, mbajti një ligjëratë për studentët e Universitetit Publik "Ukshin Hoti" në Prizren, me temën: Sfidat e FSK-së në përmbushjen e kapaciteteve operacionale.

Gjeneralmajor Rrahman Rama, njëherësh edhe komandant i Forcave Tokësore, i njoftoi studentët dhe profesorët e këtij universiteti për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për: misionin, strukturën, shkollimin, bashkëpunimin e përgjithshëm të FSK-së, kapacitetet ekzistuese në kuadër të njësive të FSK-së, si dhe për të ardhmen e saj.

Po ashtu i njoftoi edhe për sfidat nëpër të cilat ka kaluara TMK-ja, shpërbërjen e saj dhe krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ndër të arriturat e përgjithshme të FSK-së, gjeneral Rama tha se ishte përmbushja e kapaciteteve të plota operacionale, të proklamuara vitin e kaluar nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, z.Rasmusen.

Në fund, zëvendëskomandanti i FSK-së foli edhe për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë në Kosovë dhe rolin e FSK-së në të ardhmen.

Studentët dhe personeli akademik i universitetit "Ukshin Hoti" shprehen interesim të madh gjatë ligjëratës, duke shtruar një numër të madh pyetjesh që kishin të bënin me të ardhmen e FSK-së.

Komandanti i FSK-së mirënjohje për kolonelin Will Smallwood nga Mbretëria e Bashkuar

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ka organizuar një takim ceremonial për kolonelin Will Smallwood nga Mbretëria e Bashkuar, me rastin e përfundimit të punës së tij, si këshilltar i komandantit të FSK-së. Ceremonia u mbajt në ambientet e Ministrisë së FSK-së, ku komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati falënderoi kolonelin Smallwood për angazhimin dhe punën e tij profesionale si dhe për kontributin e dhënë me këshilla dhe trajnime të ndryshme për FSK-në. Me këtë rast gjeneral Kastrati tha :" Koloneli Will Smallwood e ka ndihmuar vazhdimisht FSK-në, ku fokusi kryesor i tij ka qenë trajnimi, mentorimi dhe këshillimi i FSK-së për operacione, trajnime e të tjera.

Më tej gjeneral Kastrati tha se FSK-ja dhe Ai personalisht, e vlerëson lartë punën profesionale dhe angazhimin e kolonelit Smallwood për zhvillimin e FSK-së, në një forcë profesionale dhe kompetente që e pavarur mund t'i përmbushë detyrat e veta.

Më pastaj, komandanti i FSK-së u zotua se ne do të vazhdojmë përpara për të zhvilluar marrëdhëniet tona profesionale me Shtetin e Britanez dhe vazhdimin



e marrëdhënieve të mira që kemi me Britaninë e Madhe, me KFOR-in, dhe ndërtimin e të ardhmes tonë, me Ekipin Këshillues-Ndërlidhës të NATO-s.

Ndërsa këshilltari i komandantit, koloneli Will Smallwood përgëzoi komandantin për të gjitha të arriturat dhe premtoi se gjithmonë do të jetë i lidhur me FSK-në. Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në shenjë falënderimi, kolonelit Will Smallwood i ndau "Mirënjohje" me motivacionin për kontributin e dhënë në zhvillimin e FSK-së.

Kompania e Deminimit e FSK-së vetëdijeson nxënësit për rrezikun nga minat dhe mjetet e pashpërthyera



Zëvendësministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK-së), Muhamet Latifi, më 21 janar 2014 vizitoi nxënësit e shkollës fillorë "Ganimete Tërbeshi" në Llukarë të Prishtinës, gjatë një ligjërate për rrezikun nga minat dhe mjetet e pashpërthyera, që u mbajt nga pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit të FSK-së.

Zëvendësministri i MFSK-së, Latifi, u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur me vizitën që i bëri nxënësve të kësaj shkolle, njëherësh ai shprehu gatishmërinë e FSK-së për bashkëpunim të mëtutjeshëm për çdo gjë që është në të mirë të qytetarëve e në këtë rast të fëmijëve. "Kam ardhur këtu t'ju vizitojë më shumë dëshirë, në emër të ministrit të FSK-së dhe gjeneralëve tanë, dhe dua t'ua rikujtoj se këto ligjërata janë shumë të rëndësishme dhe shpresoj se do të jenë të efektshme për ju, për t'u informuar më gjerësisht për rrezikun nga minat dhe mjetet e pashpërthyera. Këto njohuri që ju po merrni nga FSK-ja duhet t'ua shpjegoni edhe fëmijëve tjerë dhe gjithë qytetarëve të Kosovës" u shpreh zv. ministri Latifi.

Edhe drejtori i shkollës fillore "GanimeteTërbeshi", Ilir Krasniqi, bashkëpunimin me FSK-në e cilësoi si shumë të rëndësishëm dhe shpreh mirënjohjen e tij për pjesëtarët e FSK-së, që po ndihmojnë nxënësit të pajisen me njohuri rreth rrezikut nga mjetet e pashpërthyera.

Ndërsa rreshteri i FSK-së, Afrim Qusaj i vlerësoi lart njohuritë e fëmijëve për sa i përket rrezikut nga minat dhe mjetet e pashpërthyera. Ai tha se tashmë fëmijët janë në gjendje t'i njohin ngjyrat, format, dhe procedurat se çka duhet ndërmarrë pasi ta shohin një mjetë të rrezikshëm. "Shumica e nxënësve falë këtyre ligjëratave janë aftësuar jashtëzakonisht shumë lidhur me mjetet e pashpërthyera, madje ka pas raste kur ata vetë na kanë informuar se kanë hasur në këto mjete.



Kompania e Deminimit e FSK-së, ligjëratat për vetëdijesim nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera i ka filluar që në muajin dhjetor (sezoni dimëror) dhe po vazhdon t'i mbajë nëpër shkolla fillore e të mesme të Kosovës.





Pjesëtarët e FSK-së trajnohen nga Garda Kombëtare e IOWA-s dhe Ushtria e Turqisë

Në kazermën "Adem Jashari" në Komandën e Forcave Tokësore (KFT), Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka filluar trajnimin për Menaxhimin e Emergjencave dhe Operacione Paqësore nga Garda Kombëtare e IOWA-s (SHBA) dhe nga ekipi i instruktorëve të Qendrës për Trajnime të Ushtrisë të Republikës së Turqisë.

Trajnimin për Menaxhimin e Emergjencave po e kryejnë 15 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe 15 të tjerë nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës. Këto trajnime janë bazuar në raportin dhe rekomandimet e EUCOM-it në bashkëpunim me Gardën Kombëtare të IOWA-s, ndërsa trajnimi për Operacione Paqësore është organizuar nga instruktorët e Qëndresë për Trajnime të Ushtrisë në Turqi (PfP-Partnership for Peace Training Center), ku po marrin pjesë 30 pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së.

Fillimin e trajnimeve e përcollën nga afër; drejtori i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), gjeneral brigade Imri Ilazi, i cili falënderoi Gardën e IOWA-s dhe Republikën e Turqisë, për ndihmën që po japin për FSK-në. Gjeneral Ilazi, me këtë rast, foli edhe për bashkëpunimin dypalësh të FSK-së për trajnimet, shkollimet dhe bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Republikën e Turqisë. "Pjesëtarët e FSK-së kanë marrë dhe po marrinë pjesë në shumë trajnime si në Kosovë edhe jashtë saj, ku nga këto trajnime kanë përfituar përvoja në menaxhimin e emergjencave dhe në operacione paqësore", ka shtuar në fund gjeneral Ilazi.



Në përcjelljen e ushtrimit të pjesëtarëve të FSK-së për menaxhimin e emergjencave dhe operacioneve paqësore, morën pjesë edhe shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri dhe shef i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, nënkolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK.

Certifikohen 30 pjesëtarë të FSK-së për Operacione Paqësore

Në ambientet e Brigadës për Mbështetje Operacionale (MBO) të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), sot u bë certifikimi i 30 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kryen me sukses një trajnim për "Operacione Paqësore", të mbajtur nga Ekipi i Instruktorëve të Qendrës për Trajnime të Republikës së Turqisë.

Në ceremoninë e certifikimit morën komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandantit i BMO-së, gjeneral brigade Ilaz Derguti, zëvendës komandantit i KFOR-it gjenerali Wessely, komandanti i NLAT-it, gjenerali Wagner dhe komandanti i kontingjenti Turk, Koloneli Topaloglu.



Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, fillimisht e falënderoi ekipin e instruktorëve të Turqisë, duke u shprehur mjaft i kënaqur me bashkëpunimin e mirëfilltë, ndërmjet FSK-së dhe Armatës së Turqisë. Ai, tha se: "Synimi i FSK-së është ngritja profesionale e kapaciteteve sipas standardeve të NATO-s, e në këtë drejtim një kontribut të madh, në këtë drejtim, po jep Ekipi i Forcave të Armatosura të Turqisë, përmes trajnimeve të shumta, e që janë të një rëndësi të veçantë për FSK-në".

Ndërsa, në emër të Qendrës për Trajnime të Republikës së Turqisë, koloneli Turk, Topaloglu premtoi se edhe në të ardhmen do ta ndihmojnë FSK-në. Ai përshëndeti të gjithë pjesëtarët e FSK-së, për interesimin dhe seriozitetin e tyre që treguan gjatë mbajtjes së këtij trajnimi, që është më rendësi për FSK-në.

Në fund, për arritjen e rezultateve dhe kryerjen me sukses të trajnimit për "Operacione Paqësore" të gjithë pjesëtarëve të FSK-së, u dhanë Certifikata.

Gjeneral Cikaqi, falënderoi kolonelin WOOD për ndihmën e vazhdueshme të SHBA-së

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneralbrigade Enver Cikaqi priti në një takim pune, komandantin e KFOR-it amerikan në Bonstill, kolonelin David Wood. Gjeneral Cikaqi, me këtë rast, falënderoi kolonelin për ndihmën e vazhdueshme që SHBA-ja dhe KFOR-i amerikan po jep për FSK-në. "Edhe gjatë vitit që lamë pas, Ushtria amerikane, që vepron në Grupin Shumëkombësh Lindja në Bondstill, ka ofruar trajnime të gjithanshme dhe ka mbështet me të gjitha format Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, përmes programeve dhe personelit



(instruktorëve) për realizimin e shumë trajnimeve, me qëllim të ngritjes profesionale, dhe për këtë i jam shumë falënderues Ushtrisë amerikane" ka thënë gjeneral Cikaqi .


Ndërsa, komandanti i Bonstillit, koloneli Wood, nga ana e tij, garantoi gjeneralin Cikaqi për vazhdimin e ndihmës për KDS-në. Ai tha:"Qëllimi i kësaj vizite të përbashkët është të kemi edhe një takim pune para se të përfundoj mandatin tim, dhe së bashku me ju, gjeneral, të bëjmë një analizë pune për realizimin e detyrave dhe përmbushjes së obligimeve, me qëllim që këtë bashkëpunim ta vazhdoni edhe me komandantin e ri, që do të vijë së shpejti në Kosovë". Koloneli WOOD shprehi falënderimet e tij për bashkëpunimin dhe sinqeritetin gjatë tërë kohës sa ka qëndruar në detyrën e komandantit të Grupit Shumëkombësh Lindje në Bondstill. Kjo ishte vizita e fundit e kolonelit WOOD si komandant në Bonstill.

Në fund, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi falënderoi kolonelin WOOD për angazhimin e tij në KDS, në avancimin e trajnimeve dhe ngritjen profesionale të FSK-së. Të dy komandantët premtuan angazhim maksimal edhe në të ardhmen, me qëllim të forcimit të këtij bashkëpunimi të ndërsjellë në mes FSK-së dhe KFOR-it amerikan.

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, certifikohen 27 pjesëtarë të FSK-së

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, ditë më parë, është mbajtur ceremonia për certifikimin e 27 pjesëtarëve të Kompanisë 2C të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, të cilët për katër muaj kanë kryer një trajnim intensiv (shtator-dhjetor 2013) nga ekipet trajnuese të Ushtrisë së Turqisë.

Ky trajnim dhe trajnimet e mëparshme me Batalionin e Parë dhe të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në mes Forcave të Armatosura të Turqisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).



Në ceremoninë e certifikimit përveç stafit komandues të BRSH-së, morën pjesë edhe koloneli Erdal Dodurga (kështilltar i komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratit), nënkolonel Metin Yilmaz (shefi i ekipit trajnues turk), nënkolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, në MFSK, nënkolonel Mehmet Lladrovci, komandant i Batalionit të Dytë të BRSH-së dhe ekipi i instruktorëve turq.

Komandanti i BRSH-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, fillimisht ka falënderua ekipet e instruktorëve të Turqisë, për kontributin që kanë dhënë në mbajtjen e trajnimeve të tilla, me qëllim të ngritjes dhe profesionalizimit të pjesëtarëve të Brigadës për Reagim të Shpejtë. Ai, nga të certifikuarit kërkoi që njohuritë e fituara nga trajnimet e deritashme t'i bartin me sukses tek pjesëtarët e tjerë të FSK-së, me qëllim të avancimit të njësive të tyre.

Ndërsa, koloneli Erdal Dodurga foli për rëndësinë e trajnimeve të këtij niveli, për bashkëpunimin e mirë në mes Armatës së Turqisë dhe FSK-së, si dhe për gatishmërinë e tyre që edhe në të ardhmen ta mbështetin FSK-në në të gjitha format e mundshme.

Në fund, gjenerali Brahimaj, komandanti i BRSH-së dhe koloneli Erdal Dodurga, ndanë certifikata për pjesëtarët e FSK-së, për përfundimin me sukses të këtij trajnimi intensiv.

Intervistë me rreshtermajor Sheryl Lion, KFOR-i Amerikan, Grupi Shumëkombësh-Lindje

FSK-ja në rrugë të mirë për trajnimin profesional të nënoficerëve



Rreshtermajor Sheryl Lion gjatë muajit shkurt e përfundon misionin në kuadër të KFOR-it amerikan, Grupi Shumëkombësh Lindje në Bonstill. Ajo që nga fillimi i punës së saj këtu, ka dhënë një kontribut të madh në realizimin e shumë trajnimeve profesionale për pjesëtarë të FSK-së, e sidomos dallohet për bashkëpunimin me Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Rreshter major Lion u dallua për angazhimin e saj profesional, për monitorimin dhe përgatitjen e instruktorëve të FSK-së, "Trajno-Trajnerët" dhe "Kursi i Avancuar i Liderit" (KAL) të realizuar së bashku me një ekip ushtarakësh amerikanë. Ekipi amerikan ka punuar ngushtë me ekipin e FSK-së, dhe se bashku kanë arritur që të adoptojnë kursin për pjesëtarët e FSK-së, i cili po zhvillohet në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Instruktorët e FSK-së, të cilët kanë kryer këtë kurs, meritat ia dedikojnë Rreshter major Sheryl Lion, e cila gjithnjë i ka mbështetur dhe motivuar për kryerjen me sukses të detyrave. Për të mësuar më shumë për bashkëpunimin dhe mbështetjen profesionale të Ekipit të KFOR-it amerikan, biseduam me Rreshter-major Sheryl Lion, e cila me dëshirë pranoi të jap intervistë për gazetën e FSK-së "Forca Jonë". Gjatë intervistës, Ajo me modesti rezultatet e punës së përgjithshme ia dedikon ekipit amerikan edhe instruktorëve të FSK-së.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është bashkëpunimi i juaj me FSK-në?*

Rreshter major Sheryl Lion: "Kemi një bashkëpunim të mirë me FSK-në, sidomos me Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Ekipi amerikan ka punuar ngushtë me ekipin e FSK-së, dhe kemi arritur që të adoptojmë kursin për pjesëtarët e FSK-së, i cili u zhvillua me sukses në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes. Kursi ka zgjatë 7 javë dhe pas përfundimit të tij janë certifikuar 12 instruktorë të FSK-së, të cilët aktualisht janë duke zhvilluar trajnimin tjetër "Trajno- Trajnerët" dhe "Kursin e Avancuar të Liderit" (KAL)". Jam shumë e kënaqur me bashkëpunimin dhe me ngritjen profesionale të instruktorëve si dhe me arritjet e përgjithshme të FSK-së.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janë arritjet e kandidatëve për instruktorë të FSK-së të cilët ju i keni menaxhuar?*

Rreshter major Sheryl Lion: "Secilin kurs për instruktorë duhet ta filloni prej asaj themelores e të vazhdoni tutje. Ne kemi filluar prej aty ku mund të përfshihen të gjithë pjesëtarët. Kërkesa për këtë kurs është bërë para dy vitesh. Pasi që FSK-ja ka pranuar këtë kërkesë, atëherë kemi filluar ta ndjekim rrugën nëpërmjet zinxhirit komandues deri te realizimi i kursit. Para se të fillojmë me realizimin e kursit, Ekipi ynë në bashkëpunim me FSK-në kanë bërë përgatitjet e nevojshme. Ne ua kemi ofruar bazën për realizimin e këtij trajnimi, të cilën instruktorët e FSK-së në të ardhmen do ta adaptojnë dhe zhvillojnë për nevojat e tyre. Vlerësimi ynë ka qenë dhe mbetet se FSK-ja ka bërë një përzgjedhje të shkëlqyeshme të kandidatëve për këtë kurs. Shumica prej tyre edhe më parë kanë ndjek disa trajnime jashtë vendit, respektivisht nëpër shkollat amerikane, dhe kjo na ka ndihmuar gjatë realizimit të kursit për të qenë sa më efikas dhe sa më të suksesshëm. Këta instruktorë vërtetë kanë qenë të shkëlqyeshëm.

Mesazhi: Nënoficerët në SHBA dëshirojnë që vazhdimisht ta zhvillojnë vetveten, kurse nënoficerët e lartë përveç vetvetes kanë obligim të zhvillojnë edhe nënoficerët tjerë. Shpresoj që kur të kthehem pas disa viteve në Kosovë të shoh zhvillimin dhe avancimin profesional edhe më të madh të nënoficerëve të FSK-së.

Gazeta "Forca Jonë": *Sa janë të gatshëm instruktorët e FSK-së ta zhvillojnë një kurs të tillë në të ardhmen?*

Rreshter major Sheryl LION: Instruktorët e FSK-së janë të gatshëm që të organizojnë dhe realizojnë kurse të tilla, ata tani janë duke mbajtur "Kursin e Avancuar të Liderit", të cilin herë-pas herë e menaxhojmë edhe nga afër. Interesimi për kursin "Trajno-Trajnerët" nga ekipi amerikan ka qenë i madh, po aq i madh ka qenë edhe interesimi i pjesëtarëve-instruktorëve të FSK-së, të cilin po e organizojnë dhe po e realizojnë me sukses në bashkëpunim me ekipin amerikan.

Gazeta "Forca Jonë": Cili është bashkëpunimi në relacion FSK-Bondstill?

Rreshter major Sheryl Lion: Pas ardhjes tonë, me rastin e ndërrimit të kontingjentit, na është dashur pak kohë qe të fillojmë takimet për vendosjen kontakteve të para. Ato relacione janë ndërtuar vazhdimisht dhe kemi bashkëpunuar me të gjitha palët, si: NLAT, ODC (Zyra për Bashkëpunim Zhvillimor), KFOR-in, me qëllim që ta ndihmojmë FSK-në, dhe kjo është shpërblyer sepse ne po i shohim rezultatet e FSK-së çdo ditë. Shumica e trajnimeve po realizohen këtu, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj.

Gazeta "Forca Jonë": *Jeni në përfundim të misionit tuaj në Kosovë, cili është mendimi juaj në përgjithësi për Kosovën dhe FSK-në?*

Rreshter major Sheryl Lion: Populli është shumë miqësor në Kosovë. Më pëlqejnë traditat dhe krenaria e këtij populli. Njerëzit na përshëndesin kudo që takohemi, kjo më bën të ndihem mirë. Në fillim të misionit tim në FSK, gjatë pjesëmarrjes sime të parë në ceremoninë e certifikimit të nënoficerëve, nga afër kam parë se sa krenar ndihen nënoficerët dhe oficerët e FSK-së për punën dhe profesionalizmin e treguar. Këtë e kam parë edhe në jetën e përditshme, këtu në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, dhe kjo po më pëlqen shumë, vetëm vazhdoni kështu. Me rëndësi për të ardhmen tuaj janë puna dhe shkollimi për arritjen e rezultateve të përgjithshme.

Gazeta "Forca Jonë": *Rreshter major, cili është mesazhi Juaj për FSK-në?*

Rreshter major Sheryl Lion: Ju dëshiroj çdo të mirë, fat dhe suksese. E di që për një kohë të shkurtër keni arritje të mëdha, pres që këto të arritje të vazhdojnë tutje, ngase rruga është dhe tani vetëm duhet të ecët përpara. Kjo më bënë të ndihem mirë. Të dy kurset, të cilat i kemi përgatitur nga instruktorët dhe nga nënoficerët amerikan, "Lideri Luftarak" dhe "Kursi i Avancuar për Lider", tashmë janë një sukses për të ardhmen, dhe të dy këto kurse po realizohen me sukses në KDS. Dëshira ime është që FSK-ja të arrin sa më larg në zhvillimin e nënoficerëve.

Në fund, ne u ndamë nga rreshter majori Lion duke i uruar shëndet dhe punë të mbarë në Amerikë, ndërsa instruktorët e FSK-së e falënderuan nga zemra për punën e palodhshme dhe mbështetjen e saj të madhe në arritjen e sukseseve.



Intervistë me Major Ejup Maqedoncin, shef i Logjistikës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së

Major Ejup Maqedonci merr titullin "Master i Shkencave dhe Arteve Ushtarake", në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së SHBA-ve

Oficerët e FSK-së vazhdojnë të tregohen të suksesshëm në trajnime edhe në shkollime jashtë vendit, madje ata kthehen edhe me medalje nderi të vendeve përkatëse, ku i përfundojnë shkollimet ose trajnimet në lëmi të ndryshme. Oficeri i radhës i FSK-së, që tregoi performancë të shkëlqyeshme gjatë shkollimit të tij, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) shpallet edhe "qytetar nderi i qytetit të Leavenworthit".



Majori i FSK-së, shef i Logjistikës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC-së), Ejup Maqedonci është edhe një tjetër oficer i FSK-së që kthehet me titull akademik dhe mirënjohje nga Shtete e Bashkuara të Amerikës (SHBA-të). Gjatë shkollimit në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (US Army Command and General Staff College - Fort Leavenëorth) prej 24 tetor 2012 deri më 13 dhjetor 2013, tregoi një performancë të shkëlqyer në mesin e shumë oficerëve amerikanë si dhe oficerëve të shteteve tjera, kjo dëshmohet edhe me vlerësimin akademik të bërë nga Kolegji CGSC, që është vlerësuar me notën më të lartë 1 (1 më e larta dhe 6 më e ulëta) si dhe në përgjithësi sa i përket notave të provimeve në vlerësimet e bëra nga instruktorët dominon nota A e që është ekuivalente me notën 10 në universitetet e Kosovës. " Shkollimi në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së SHBA-ve ishte një eksperiencë e veçantë për mua. Atje përpos njohurive të reja të aspektit të strategjisë, operacioneve dhe taktikes ushtarake kam fituar dhe njohuri të reja rreth kulturave të ndryshme, e në veçanti rreth kulturës dhe vlerave amerikane.

Gjatë gjithë kohës së qëndrimit tim atje jam ndier krenar që përfaqësoja Kosovën në njërin nga institucionet më të vlerësuara edukative ushtarake në Botë, siç është CGSC. I vetëdijshëm për nevojën që ka FSK-ja për ngritjen dhe zhvillimin profesional, besoj dhe do të angazhohem që njohuritë e fituara atje t'i vej në shërbim të FSK-së dhe vendit tim", tha major Maqedonci. Gjatë kësaj periudhe, ai ka përfunduar trajnimet për Kursin e Gjuhës Profesionale Ushtarake Angleze, në Institutin e Gjuhëve të Huaja (DLI) San Antonio, Texas, SHBA: Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Fort Leavenworth, Kansas, SHBA. Po ashtu ai ka bërë edhe shkollim shtesë në fushën e shkencave dhe arteve ushtarake në kuadër të së cilave ka përfunduar dhe tezën e masterit me titull: "Mbështetja e Kosovës për Operacionet e NATO-s", ku ka fituar titullin " Master i Shkencave dhe Arteve Ushtarake" (Msc dhe MA).

Qëllimi i shkollimit në SHBA ishte përfitimi i njohurive të përgjithshme ushtarake në aspektin e komandimit, planifikimit dhe organizimit, ku u përfshinë lëndët dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me: Strategjinë ushtarake, Operacionet, Taktikën, Lidershipin, Historinë ushtarake, Mbështetjen, Etikën ushtarake, Mendimin kritik, Studimet regjionale evropiane, Procesi i marrjes së vendimeve ushtarake, Ushtrimet në vendkomandë etj.

Ejup Maqedonci gjatë karrierës së tij prej ushtaraku që nga koha e UÇK-së, me pas TMK-së dhe tani në FSK, ka pasur disa detyra dhe funksione të ndryshme, si: Shef i Sektorit të Mbështetjes Logjistike të Regjimentit të Mbrojtjes Civile; Komandant i Kompanisë së Kërkim-Shpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së); Komandant i Kontingjentit të FSK-së gjatë përmbytjeve në Shkodër, Republika e Shqipërisë; Komandant i Batalionit të Kërkim-Shpëtimit të Brigadës së Mbrojtjes Civile (TMK); Komandant i Batalionit të Parë të Brigadës 153 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ka përfunduar disa trajnime të rëndësishme edhe në fusha të ndryshme, ku edhe merr tituj të rëndësishëm ushtarak, si: Instruktor i Topografisë dhe përdorimit të sigurt të armëve, KDS, në Prishtinë (Inst. Britanik); Instruktor i Repelimit; Instruktor i Kërkim-Shpëtimit Urban: Këshilltar Ndërkombëtar i Kërkimit Luftarak (Qendra Ushtarake në Chatham-Britani e Madhe), Instruktor i përgjithshëm i kërkim-shpëtimit dhe menaxhimit të emergjencave-kurs tremujor (i realizuar në qytetin e Japonisë OSAKA), i certifikuar në nivelin e parë të zhytjes, në Kosovë (Federata e Zhytjes); Qytetar Nderi i Leavenworthit (SHBA).

Gjatë periudhës 15 vjeçare si ushtarak, Ejup Maqedonci ka marr shumë mirënjohje nga krerë të lartë të shteteve duke filluar nga Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë, Mbretëria e Japonisë, SHBA-të etj. Medalja për Shërbim Ushtarak nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë (08.07.2011); Medalja për Shërbime të Shquara nga Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë (16.02.2010); Medalja e Shërbimit në TMK, nga Komandanti i TMK-së (2008); Dekoratën "Zahir Pajaziti" të UÇK-së (28 Nëntor 2000) nga Komandanti i ZOLL-it; Mirënjohje nga Ministri i FSK- së, për ndihmën e dhënë gjatë përmbytjeve në Shkodër, (2010); Mirënjohje nga Komandanti i FSK-së, për ndihmën e dhënë gjatë përmbytjeve në Shkodër(2010); Mirënjohje nga Prefekti i Prefekturës Shkodër, Janar 2010; Mirënjohje për profesionalizmin e treguar në TMK, nga Komandanti i Zonës së Pestë Mbrojtëse; Mirënjohje për kontributi në UÇK nga OVL e UÇK-së.

Major Ejup Maqedonci ka lindur në Prishtinë më 09.05.1977. Gjatë luftës në Kosovë (1998-1999) ishte Komandant i Batalionit të Parë të UÇK-së në Brigadën 153 të Z.O.LL. Nga viti 2006 deri më 2009 ka përfunduar studimet Baçellor në Kolegjin "Pjeter Budi", në Prishtinë, në drejtimin e Doganës dhe Shpedicionit. Gjatë kohës së shërbimit në TMK, ka udhëhequr Batalionin e Kërkim-Shpëtimit dhe gjatë kësaj periudhe ka udhëhequr shumë operacione si dhe ka marrë pjesë në shumë trajnime të organizuara nga forcat e NATO-s dhe institucionet tjera në Kosovë. Me krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës është emëruar në detyrën e Komandantit të Kompanisë së Kërkim-Shpëtimit. Gjatë kohës sa ka shërbyer në këtë detyrë ka ndjekur trajnime specialistike për kërkim-shpëtim në Britani të Madhe dhe Japoni. Në vitin 2010 dy herë është caktuar si Komandant i Kontingjentit të FSK-së në Republikën e Shqipërisë, gjatë operacionit humanitar dhe të shpëtimit në Shkodër. Në vitin 2011 është avancuar në gradën Major, si Shef i Logjistikës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile. Në vitin 2012-2013, ka ndjekur studimet në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Fort Leavenworth, ku përpos diplomimit në Kolegj, ka përfunduar dhe studimet e shkallës Master dhe ka fituar titullin "Master i Shkencave dhe Arteve Ushtarake".



Kompania e Mjekësisë në shërbim të gjithë pjesëtarëve të FSK-së edhe qytetarëve të Kosovës



Shkruan: Nënkolonel dr. Hamide OSAJ

Kompania e Mjekësisë gjatë vitit që lamë pas ka realizuar të gjitha detyrat me përgjegjësi të madhe. Ekipet mjekësore të saj, ju ofrojnë asistencë mjekësore në shumë fshatra të banuara kryesisht me pjesëtarë të komuniteteve, gjithashtu së bashku me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, brenda vitit organizon dhurimin vullnetar të gjakut në kazermat e FSK-së, ku nga pjesëtarët e FSK-së për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë, dhurohet vullnetarisht mbi 1000 doza gjak, etj.

Struktura e Kompanisë së Mjekësisë përbëhet prej grupit komandues, ekipit të mjekimit, tri ekipeve të evakuimit, ekipit të farmacisë, si dhe sektorit civil, që përbehet nga shërbimi i stomatologjisë, mjekësisë preventive (e paplotësuar) dhe veterinës (e paplotësuar). Kompania e Mjekësisë është përgjegjëse për ndihmë mjekësore mobile dhe evakuim mjekësor nga terreni deri në spitalet civile si mbështetje e njësive të FSK-së. Gjithashtu, KM e mbështet FSK-në me shqyrtime mjekësore, këshilla profesionale për stafin dhe stërvitjen mjekësore. Sipas urdhrit, ofron mbështetje mjekësore për autoritetet civile në Kosovë, si dhe merr pjesë në operacionet e përbashkëta jashtë vendit.

Kompania e Mjekësisë çdo ditë ofron shërbime ambulatore të mjekësisë së përgjithshme dhe stomatologjike, intervenime mjekësore (injeksione, infuzione, pastrim plagësh, etj), evakuime mjekësore me autoambulanca, mbështetje mjekësore për njësitë tjera të FSK-së dhe autoritetet civile, varësisht nga urdhrat.

Kompania e Mjekësisë kryen shërbime mjekësore nga mjekësia e përgjithshme, si dhe i plotëson të gjitha kërkesat nga stomatologjia.

Në bazë të misionit, Kompania e Mjekësisë i mbulon të gjitha nevojat për shërbime mjekësore për pjesëtarët e FSK-së. Njësitë e FSK-së janë të dislokuara në disa qytete të Kosovës me personel mjekësorë të sistemuar në këto lokacione. Në çdo kazermë të FSK-së ka shërbime mjekësore si, në: Batalionin e Parë të BRSH-së në Gjilan, Batalionin e Dytë të BRSH-së në Istog, Batalionin e Tretë në Mitrovicë, në RMC - Pomozetin, në Kompaninë e Deminimit në Prizren, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj.

Kompania e Mjekësisë i mbështet të gjitha ushtrimet fushore në nivel vendi dhe merr pjesë aktivisht në to, por gjithashtu në vitin 2013 KM ka



marr pjesë edhe në ushtrimin fushor që është mbajtur në Republikën e Maqedonisë (nën organizim të EUCOM), ku kanë marrë pjesë 7 shtete të ndryshme.

Kompania e Mjekësisë ka pajisje të mjaftueshme për shërbime mjekësore në terren.

Kompania e Mjekësisë ka bashkëpunim të mirë me QKUK-në dhe spitalet në nivel vendi si dhe me IKSHPK (çdo vit na furnizon me vaksina kundër gripit sezonal) dhe QKTGjK.

Shërbimi mjekësor i FSK-së është gjithmonë i gatshëm të ndihmojë autoritetet civile me të gjitha kapacitetet e veta që ka në dispozicion sa herë që paraqitet nevoja.

Gjatë vitit kemi ofruar mbështetje mjekësore, Ministrisë së Diasporës, Shoqatës së Çiklizmit,

Shoqatës së Diabetikëve, transferimin e pacienteve në QSU-Tiranë, etj.

Momentalisht ekipet mjekësore të Batalionit të Dytë janë duke ofruar asistencë mjekësore në fshatrat e banuara kryesisht me pjesëtarë të komuniteteve, si në Komunën e Burimit, etj.

FSK-ja së bashku me QKTGJK, brenda vitit, dy herë (qershor dhe dhjetor), organizon dhurimin vullnetar të gjakut në kazermat e FSK-së, ku dhurohet mbi 1000 doza gjak, për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë.

Stafi i Kompanisë së Mjekësisë në vitin 2013, është dalluar për kryerjen e të gjitha detyrave dhe trajnimeve mjekësore në Gjermani, certifikimin e një instruktori për gjuhë angleze në SHBA, një pjesëtar i KM-së është certifikuar nga KFOR-i amerikan për instruktor të trajnimit: Personi i Parë në Vendngjarje, shkëmbim përvojash mjekësore me EUCOM-in, Spitalin Ushtarak në Hamburg të Gjermanisë, etj. Bordi mjekësor ka realizuar shqyrtimet mjekësore vjetore për personelin e FSK-së, por ajo që e dallon Kompaninë e Mjekësisë është suksesi i jashtëzakonshëm i arritur në ushtrimin fushor në Republikën e Maqedonisë (ku kanë marrë pjesë shtatë shtete: Shqipëria, SHBA, Bosnja, Maqedonia, Sllovenia, Mali i Zi dhe Kosova.



FSK-ja në Kampionatin Regjional të Atletikës Ushtarake në Llozanë të Zvicrës

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) në kuadër të bashkëpunimit me Komitetin Ndërkombëtar të Sporteve Ushtarake për Evropë (CISME), nga data 17-19 jaar 2014 mori pjesë në Kampionatin Regjional të Atletikës, "Cross Country Sport", që u mbajt në qytetin e Llozanës -Zvicër, ku për herë të parë nga Ushtria Zvicerane si nikoqir i garave është ftuar edhe një ekip i FSK-së.

Në këtë kampionat ishin pjesëmarrës 13 delegacione dhe ekipe ushtarake nga shtetet që bëjnë pjesë në grupin prestigjioz të vendeve që e përbëjnë Grupin Regjional Nordik-Beneluks të CISM-it, si dhe disa ekipe mysafir, si ekipet ushtarake nga: Zvicra, Gjermania, Belgjika, Holanda, Franca etj.

Delegacioni i FSK-së përbehej nga tetë pjesëtarë, ku në kuadër të ekipit garues ishin katër ushtarë dhe dy ushtare, të cilët garuan në dy disiplina: vrapim në shtigje të shkurta dhe shtigje të gjata. Në vrapimin e shtigjeve të gjata morën pjesë dy ushtarë dhe dy ushtare të FSK-së. Gara ishte shume e fortë, edhe pse pjesëtarëve të FSK-së u mungonte përvoja arritën të dallohen me përkushtimin, angazhimin dhe disiplinën e treguar gjatë këtij kampionati. Pjesëmarrja e ekipeve të FSK-së është vlerësuar lartë nga delegacionet ushtarake të vendeve të lartpërmendura, dhe ato gjithashtu kanë shprehur gatishmërinë e tyre që ta ftojnë FSK-në në aktivitetet që do të mbahen në vendet e tyre. Udhëheqësi i delegacionit të FSK-së, nënkolonel Fadil Hoxha, pas kthimit ka thënë: "Në Llozanë jemi pritur dhe trajtuar shumë mirë nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, ne kemi garuar me të gjitha ekipet ushtarake pjesëmarrëse si: Zvicra, Gjermania, Belgjika, Holanda dhe Franca. Garat ishin shumë të forta dhe pjesëtarët tanë janë vlerësuar lartë nga delegacionet ushtarake", shtoi në fund nënkolonel Hoxha.



Me nderime varroset Blerim Krasniqi, tetar i FSK-së

Më 1 janar 2014, në varrezat e fshatit Tërpezë të Malishevës, me nderime të larta u varros tetar Blerim Skënder Krasniqi pjesëtar i FSK-së, me detyrë në Qendrën e Studimeve Universitare (Shkollën Ushtarake të FSK-së) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Blerim Krasniqi u lind më 02. 03. 1978 në fshatin Tërpezë, Komuna e Malishevës. Blerimi mësimet e para i kreu në shkollën fillore të fshatit të tij të lindjes, ku dallohet në mësime dhe në shkathtësitë e tij në aktivitete të lira. Shkollën e mesme e kreu në fshatin Kijevë të Malishevës. Qysh në moshën e re, Blerimi së bashku me babanë e tij Skënderin, iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Brigadën 121 "Kumanova".

Pas përfundimit të luftës, Blerimi u sistemua në Gardën e Kosovës të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Më 2009, me krijimin e FSK-së, Blerimi ka punuar në Qendrën për Studime Universitare (Shkollën Ushtarake të FSK-së) të Forcës së Sigurisë të Kosovës, e cila vepron në kuadër të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS). Ai gjatë kësaj kohe, dallohet me angazhimin maksimal edhe në arritjen e rezultateve të shkëlqyeshme. Më 31 dhjetor, pas një sulmi kardiak, Blerimi u nda nga



jeta në moshë të re, kur më së shumti i duhej familjes së tij dhe FSK-së. Blerimi ishte i martuar dhe la pas gruan dhe dy djem.

Ceremonia e varrimit u bë me përcjellje të Togut Ceremonial të FSK-së. Para qytetarëve të shumtë, që kishin ardhur për t'i dhënë lamtumirën e fundit Blerim Krasniqit, fjalën mortore në emër të FSK-së e mbajti komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili foli për punën, profesionalizmin dhe angazhimin e pakursyer të tij në FSK. Më pastaj foli përfaqësuesi i Shoqatës së Veteranëve të Komunës së Malishevës, i cili rikujtojë pjesëmarrjen e Blerimit në moshë fare te re në radhët e UÇK-së, më pas ai foli për punën e tij në TMK dhe si pjesëtar i FSK-së. Në emër të familjes nga familjaret e tij u falënderuan të gjithë pjesëmarrësit që gjetën kohë për t'i bërë nderimet e fundit Blerimit dhe për të ndarë dhimbjen me ta.

Për të përcjellë Blerim Krasniqin për në banesën e fundit kishin ardhur; zëvendësministrat Muhamet Latifi e Bejtush Gashi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i Komandës së Forcës Tokësore (KFT-së) gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi, oficerë të lartë, nënoficerë dhe ushtarë të FSK-së, veteranë të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të shumtë.

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 21 • Shkurt 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *



Ministri i FSK-së Agim Çeku priti ambasadorin e SHBA-ve, në NATO, Douglas Edward Lute

Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Agim Ceku me bashkëpunëtorë, priti në ambientet e Ministrisë, ambasadorin e SHBA-ve në NATO, Douglas Edward Lute të shoqëruar nga ambasadorja e SHBA-ve në Kosovë Tracey Ann Jacobson dhe anëtarë të tjerë të delegacionit.

Ministri Agim Çeku e njoftoi ambasadorin Lute me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të posaçëm foli për punën që është bërë në Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë. Duke falënderuar ambasadorin Lute për kontributin e tij në NATO në përkrahje të FSK-së, ministri Çeku kërkoi nga ai që të vazhdojë ta mbështesë angazhimin e MFSK-së dhe Kosovës për anëtarësim në Programin e Partneritet për Paqe të NATO-s.

Nga ana e tij ambasadori Douglas Lute premtoi angazhimin e tij dhe SHBA-ve për të shtyrë përpara agjendat e Kosovës dhe të FSK-së për bashkëpunim me NATO-n.


Gjenerali amerikan Dempsey ia uron Komandantit të FSK-së gjeneral Kastratit Ditën e Pavarësisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 11 shkurt 2014, pranoi një letër urimi nga Kryesuesi i Shefave të Shtabeve të Bashkuara të Ushtrisë Amerikane, gjeneral Martin Dempsey.

Gjeneral Dempsey në letër urimin drejtuar gjeneral Kastratit shprehet: "Në emër të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në emër të Komandës së Bashkuar të Shefave të Shtabeve, ju përgëzoj Ju dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës me rastin e Ditës së Pavarësisë."


Më tej gjenerali amerikan, Martin Dempsey është shprehur në letër: "Kam shumë besim se miqësia dhe bashkëpunimi ndërmjet dy ushtrive tona do të rritet edhe më shumë". Në fund gjenerali Dempsy ka shprehur edhe interesimin e tij që sa më shpejt t'i shoh të publikuara rezultatet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë si dhe zbatimin e tyre.





Ky ishte teksti i urimit që gjenerallejtënant Kadri Kastrati ka pranuar me rastin e Ditës së Pavarësisë nga gjenerali amerikan Martin Dempsey.

Ndihmë e vazhdushme e SHBA-së për MFSK-FSK-në



Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me bashkëpunëtorë, pritën në takime të ndara përfaqësuesin Ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Komitetin Ushtarak të NATO-s (USMILREP), gjenerallejtënant David R. Hogg, i cili shoqërohej edhe nga atasheu ushtarak i SHBA-s në Kosovë, koloneli James Kott.

Ministri Çeku e gjeneral Kastrati e njoftuan gjeneralin Hogg me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të veçantë ata folën për punën që është bërë në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Ministri Çeku gjithashtu paraqiti aspiratën e institucionit për fillimin e punës në drejtim të arritjes së vizionit për integrime euro-atlantike, aspiratë kjo e popullit të Kosovës, sepse historia me e re e Kosovës është e lidhur ngushtë me NATO-n.

Ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati e falënderuan gjeneralin Hogg për ndihmën e madhe që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë për zhvillimin e FSK-së dhe profesionalizimin e saj. Gjithashtu, të parët e FSK-së, kërkuan nga gjenerali Hogg të vazhdoi të përkrahë angazhimin e FSK-së dhe të Kosovës për anëtarësimin në Programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s.

Ndërsa, gjenerallejtënant David Hogg premtoi angazhimin e tij dhe të SHBA-së për ta ndihmuar edhe më tej Kosovën dhe FSK-në.



FSK-ja parakalon në gjashtë vjetorin e Pavarësisë

Me parakalimin e kuadrateve të gjitha njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, në sheshin "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti" të Prishtinës, filloi zyrtarish, shënimi i manifestimit qendror të përvjetorit të gjashtë të shpalljes së Pavarësisë të Republikës së Kosovës.

Fillimisht presidentja Jahjaga dhe kryeministri Thaçi vendosën kurora me lule pranë shtatoresës së heroit të Kosovës Zahir Pajaziti, në ndërim të të gjithë të rënëve për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.

Trecy Jacobson: SHBA do të mbështesin gjithmonë Kosovën

Në përvjetorin e gjashtë të Pavarësisë së Kosovës, ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Prishtinë, znj. Trecy Jacobson, në fjalën e saj, ka lexuar letrën e presidentit Barak Obama për Kosovën, ku pos tjerash thotë, në gjashtë vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, nisja e bisedimeve me BE-në për marrëveshjen e stabilizim-asocimit shënon edhe një të arritur të rëndësishme të Kosovës. Me këtë dialog udhëheqësit e Kosovës kanë thurë rrugën e Kosovës që do të përmirësojnë jetën e qytetarëve dhe do të çojë përpara synimet e saj drejt integrimeve evropiane" ndërsa, për sektorin e sigurisë, NATO-ja ka deklaruar se Forca e Sigurisë së Kosovës i ka arritur kapacitetet e plota operacionale dhe ka ndërmarrë përpjekje mbresëlënëse për rekrutimin e serbeve të Kosovës. **(Vijon në faqen 4-5)**

Kryeministri Hashim Thaçi shpalosi idenë për Forcat e Armatosura të Kosovës gjatë vizitës në FSK

Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, qëndroi për një vizitë pune në kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), ku u prit nga stafi i lartë i MFSK-së, ministri Agim Çeku, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministrat Muhamet Latifi e Bejtush Gashi, si dhe gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, para stafit më të lartë të FSK-së, në kazermën "Adem Jashari" tha: "Themelimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës, janë segmente përmbyllëse të institucioneve që rrumbullakojnë shtetësinë e Kosovës."

I pari i Qeverisë, Hashim Thaçi, tha gjithashtu se FSK-ja është storje e suksesshme e ndërtimit dhe ngritjes së një strukture të rëndësishme të Republikës së Kosovës. Ai tha se që nga janari i vitit 2009, Forca e Sigurisë së Kosovës u themelua si forcë e sigurisë profesionale, e armatosur, e uniformuar dhe me përbërje shumetnike dhe se themelimi, zhvillimi, strukturimi dhe organizimi i FSK-së që nga fillimi është bazuar në praktikat më të mira të shteteve me demokraci të zhvilluar.

Kryeministri Thaçi, në fjalën e tij shtoi: "Deri më tani Forca e Sigurisë së Kosovës ka kryer operacione të kërkim-shpëtimit, asgjësimit të mjeteve të pashpërthyera, zjarr-fikjes dhe detyrat të tjera të caktuara të asistencës humanitare. Forca e Sigurisë së Kosovës mund të krenohet me shumë arritje të realizuara brenda mandatit të saj të tanishëm. Tani, është koha kur ne duhet të marrim përgjegjësinë e plotë për sigurinë e shtetit tonë, e kjo do të nënkuptojë ndryshime të rëndësishme në mandatin, misionin, madhësinë dhe strukturën e saj. Pra Forcat e Armatosura të Kosovës do të zhvillohen ashtu që të janë të gatshme dhe të afta ta mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, do t'i mbrojnë interesat e Kosovës, qytetarët e saj dhe pronën e tyre, do të kontribuojnë për ndërtimin dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe atij global.



Ministri dhe Komandanti i FSK-së në nderim të së kaluarës së lavdishme



Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me oficerë të lartë të FSK-së, përvjetorin e gjashtë të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, e filluan pikërisht në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", në Prekaz, ku bënë homazhe dhe vendosen kurora me lule.

Në Prekaz, për homazhe ishte edhe ministri i MFSK-së, z. Agim Ceku, së bashku me delegacionin e Qeverisë së Kosovës. Me këtë rast, ministri Ceku dhe gjeneral Kastrati çmuan lartë sakrificën e pashembullt të familjes Jashari për Liri dhe Pavarësi.

Aftësia që ne vet, shtoi kryeministri, ta mbrojmë vendin tonë dhe t'i plotësojmë nevojat tona të sigurisë është, po ashtu, parakusht për integrimin e suksesshëm të Kosovës në strukturat veri -atlantike.

Në fund, kryeministri Thaçi tha se në rrugëtimin tonë të mëtutjeshëm drejt zhvillimit të Forcës së Re Mbrojtëse, ne do të vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë, të cilët i falënderoj për ndihmat e pakursyera që kanë dhënë në këtë drejtim.

Ndërsa, ministri i FSK-së, Agim Çeku, tha se arsyeja e vizitës së kryeministrit është që së bashku me ne të ndajë vizionin e tij, projektin e tij, e që në manifestimin qendror të 17 Shkurtit, në përvjetorin e pavarësisë e dha një lajm të mirë, shumë të pritur për Kosovën, një lajm ku përfundimisht po përmbushen pritjet e ushtarëve të Kosovës, ku po përmbushet e drejta legjitime e Republikës së Kosovës për të pasur Ushtrinë e vetë dhe po realizohet ëndrra e çdo qytetari të Kosovës.

Në fund, ministri Çeku premtoi se FSK-ja do të vazhdojë edhe në të ardhmen të punojë me përkushtim. "Deri sa të miratohet ligji i ri në Parlament, ne do të vazhdojmë punën edhe gjatë këtij mandati me përkushtim të njëjtë, me entuziazëm të njëjtë, dhe me një optimizëm të madh".

Në fund, kryeministri së bashku me ushtarë, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, drekuan në kuzhinën e FSK-së.







Komandanti i FSK-së pranoi një letër urimi për Pavarësin e Kosovës nga komandati i Komandës së Bashkuar të SHBA-ve për Evropë, gjeneral Breedlove

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati pranoi një letër urimi me rastin 17 Shkurtit -Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës nga gjenerali me katër yje Philip M. Breedlove, komandant i Komandës së Bashkuar të SHBA-ve për Evropë.

Gjenerali Breedlove në emër të ushtarakëve të Komandës së Bashkuar të SHBA-ve për Evropë, në letrën e tij shprehet se i uron komandantit të FSK-së dhe nëpërmjet tij edhe të gjithë pjesëtarëve të FSK-së Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Më tej në letrën e tij gjenerali Breedlove shkruan se: Përmbyllja e procesit nga FSK-ja e ka bërë këtë institucion shembull të shkëlqyer të suksesit në regjion." Unë, ka vazhduar më tej në letër gjenerali amerikan Breedlove, e çmoi lidershipin tuaj në bërjen e FSK-së pjesë e integrimeve regjionale si dhe në punën e përbashkët për të ecur përpara në partneritet të ngushtë me Komandën e Bashkuar të SHBA-ve për Evropë(USEUCOM) dhe NATO.

Lidhjet e ngushta ndërmjet Kosovës dhe SHBA-ve janë thelluar në vazhdimësi edhe përfaqësojnë një shembull pozitiv për rajonin e Ballkanit", përfundon letrën gjenerali amerikan Breedlove, duke ritheksuar se Ai do të vazhdoi të angazhohet për Kosovën edhe më tutje, dhe se lutet që paqja dhe prosperiteti ta përcjell Kosovën për shumë e shumë vite tjera.

Ministri i FSK-së Agim Çeku dhe Atasheu ushtarak i Gjermanisë nënkolonel Rupert Steeger nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për emërimin e këshilltarit gjerman në MFSK

Ministri për ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Agim Çeku priti në takim Atasheun ushtarak të Republikës së Gjermanisë, nënkolonel Rupert J.J. Steeger, pas të ciliat nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.

Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet të dy ministrive e rregullon çështjen e emërimit të një këshilltari gjerman për çështje logjistike në ministrinë për Forcën e Sigurisë.

Në tekstin e marrëveshjes janë të definuara fushat konkrete që e intensifikojnë bashkëpunimin në fushën e sigurisë, gjithashtu edhe misionin, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarin gjerman që do të jetë i integruar në kuadër të ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në takim, si dhe gjatë nënshkrimit të marrveshjes së bashkëpunimit për emërimin e këshilltarit gjerman për çështje logjistike në Ministri, ishte i pranishëm edhe ushtruesi i detyrës së shefit të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK, nënkolonel Hasan Hoxha.

Marrëveshja e sotme e bashkëpunimit është rezultat i bashkëpunimit të dy ministrive dhe konform Marrëveshjes Bilaterale që ka Ministria e Forcës së Sigurisë me Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë.



FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Agim Çeku e dekoroi me Medalje, komandantin e Gardës Kombëtare të IOWA-s, gjeneralmajorin Timothy Orr





Ministri dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pritën në takime të ndara komandantin e Gardës Kombëtare të Iowa-s, gjeneralmajorin Timothy Orr, me bashkëpunëtorë.

Ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati falënderuan komandantin e Gardës Kombëtare të IOWA-s, gjeneralin Orr, për ndihmat e vazhdueshme profesionale që po japin për FSK-në. Ata, gjithashtu, njoftuan delegacionin e Amerikës për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë.



Me këtë rast, ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku, në shenjë mirënjohje për angazhimin dhe kontributin e dhënë për zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së, komandantin e Gardës Kombëtare të IOWA-s, gjeneralmajorin Timothy Orr e dekoroi me medalje,

"Për shërbim meritor, për kontribut të jashtëzakonshëm, partneritet dhe mbështetje të vazhdueshme në zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në një institucion profesional, kompetent dhe të aftë"

Ndërsa, komandanti i Gardës Kombëtare të IOWA-s, gjenerali Orr, falënderoi ministrin Çeku dhe komandantin e FSK-së, gjeneral Kastratin, për dekoratën dhe për bashkëpunimin e deritashëm si dhe premtoi thellimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Nënshkruhet Programi i Bashkëpunimit në mes Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë dhe Ministrisë së FSK-së





Një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë, qëndroi për një vizitë zyrtare pune, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ku u prit nga drejtori i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK-së, nënkolonel Hasan Hoxha.

Delegacionin e Ministrisë së Sllovenisë e priti edhe ministri i FSK-së, z. Agim Ceku, i cili fillimisht e falënderoi Qeverinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë për ndihmat që ajo po jep për FSK-në, si dhe e njoftoi për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për bashkëpunimin rajonal, ndërkombëtar dhe për zhvillimin e FSK-së, në të ardhmen.

Ky takim u realizua në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Bilateral në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë, të nënshkruar gjatë vitit 2013. Qëllimi i vizitës ishte vazhdimi i bashkëpunimit të dyanshëm, shkëmbimi i përvojave dhe njohurive në fushën e përgjithshme në mes dy ministrive, asaj të FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Sllovenisë.

Më pastaj, të dy delegacionet në përbërje të zgjeruar i vazhduan punimet gjatë ditës, me ç'rast edhe drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, z. Faruk Geci, bëri një prezantim lidhur me mënyrën dhe format e bashkërendimit të bashkëpunimit të mëtejmë, me qellim që të përfitohen njohuri dhe eksperienca të dyanshme.

Në fund u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim, "Programi i Bashkëpunimit Bilateral për vitin 2014", nga nënkolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK dhe z. Gregor Zupan, shef i Sektorit të Marrëdhënieve Multilaterale në Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë.

Në kuadër të këtij Programi janë paraparë nëntë (9) aktivitete, përfshirë këtu trajnime të ndryshme në institucionet e arsimimit ushtarak të Sllovenisë, vizitat e ekspertëve me qëllim të shkëmbimit të përvojave në fusha të ndryshme, si dhe avancimi drejt integrimeve euro-atlantike.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti fëmijët e "SOS-Fshatit"





Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, së bashku me stafin e tij, pritën 50 fëmijë të "SOS-Fshatit" nga Prishtina, të grupmoshave gjashtë vjeçare (lindur me Pavarësinë e Shtetit të Kosovës), në ambientet e FSK-së.

Gjeneral Kastrati pasi i përshëndeti fëmijët dhe arsimtarët, shtoi:"Sot, jam njeriu më i privilegjuar dhe më i lumtur, për këtë vit, që i pres fëmijët e moshës së krijimit të Shtetit të Kosovës". Më pas ai foli për aktivitetin e ushtarëve, shkollimin dhe punët e tjera që i kryejnë pjesëtarët e FSK-së.

"A është vështirë të bëhesh ushtar? Me çka merren ushtarët? Ishin këto disa nga pyetjet e fëmijëve, që ia drejtuan komandantit. Shumica e tyre, në pyetjen e komandantit, se çka do të bëheni kurrë të rriteni, shprehën dëshirën për t'u bërë ushtarë të Kosovës.

Në fund, fëmijët u shprehen të lumtur për vizitën e tyre në FSK, dhe gëzimin e tyre e shprehën duke këndur këngët : Xhamadani Vija-Vija dhe Himni i Flamurit.

Manifestimi qendror i Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt, u mbajt në sheshin "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti"

FSK-ja parakaloi në gjashtë vjetorin e Pavarësisë

Me parakalimin e kuadrateve të të gjitha njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, në sheshin "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti" të Prishtinës, filloi zyrtarisht, shënimi i manifestimit qendror të përvjetorit të gjashtë të shpalljes së Pavarësisë të Republikës së Kosovës.



Fillimisht presidentja Jahjaga dhe kryeministri Thaçi vendosën kurora me lule pranë shtatores së heroit të Kosovës Zahir Pajaziti, në nderim të të gjithë të rënëve për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.

Kryeministrit Thaçi paralajmëroj formimin e FA në shënimin e përvjetorit të gjashtë të Pavarësisë së Kosovës

Në manifestimin qendror me rastin e gjashtë-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, në fjalën e tij për të pranishmit shtoi: "Sot, para nesh është e rreshtuar dhe e gatshme për parakalim Forca e Sigurisë së Kosovës, për të shënuar solemnisht gjashtë-vjetorin e Pavarësisë së shtetit tonë të lirë dhe demokratik. Prandaj është nder dhe privilegj që t'ju drejtohem në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për t'ua uruar këtë ditë për të cilën secili prej jush keni dhënë kontribut të jashtëzakonshëm.

Njëkohësisht dua t'ju falënderoj çdo njërin prej jush për shërbimin e përkushtuar, për dedikimin, profesionalizmin dhe ndjenjën e detyrës që secili e bartni më vete.

Të nderuar ushtarë dhe oficerë të FSK-së,

Institucioni që përfaqësoni ju është treguesi më i mirë i forcimit dhe konsolidimit të shtetit tonë të



ri. Ju keni kaluar nëpër disa faza të rëndësishme, gjithnjë duke ruajtur kontinuitetin, qëllimin dhe arritjet strategjike në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe mbrojtjes së vendit tonë.

Prandaj, e themi me krenari, se Forca e Sigurisë së Kosovës është vërtet një storie e suksesshme e ndërtimit dhe ngritjes së një institucioni të rëndësishëm të Kosovës. Shumica nga ju keni dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, keni dhënë kontribut të vlerësuar dhe pranuar botërisht në kuadër të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, duke bashkëpunuar ngushtë me ekspertët e shteteve mike të Kosovës, me ekspertët e NATO-s dhe të KFOR-it.

Shpallja e Kosovës Shtet i Pavarur dhe Sovran, gjashtë vjet më pare, krijoi kushte që TMK-ja të hyjë në një fazë të re.

Që nga janari i vitit 2009, Forca e Sigurisë së Kosovës u themelua si forcë e sigurisë profesionale, e armatosur, e uniformuar dhe me përbërje shumetnike.

Zhvillimi, strukturimi dhe organizimi i FSK-së që prej fillimi është bazuar në praktikat më të mira të shteteve të demokracisë së zhvilluar.

Kosova, ndërkaq, ka hapur perspektivë të gjithanshme, duke shënuar të arritura në planin e brendshëm të zhvillimit ekonomik, por edhe në atë diplomatik.

Kosova ka përfunduar me sukses mbikëqyrjen e pavarësisë, është bërë anëtare e Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, dhe tashmë njihet nga 106 shtete.

Kosova ka shënuar progres në përmbushjen e parakushteve për integrime evropiane.

Që nga themelimi i FSK-së kanë kaluar pesë vite, dhe bashkë me zhvillimin dhe forcimin e shtetit tonë edhe Forca e Sigurisë së Kosovës është ngritur, zhvilluar dhe është bërë më e fortë dhe më profesionale.

Deri tani Forca e Sigurisë së Kosovës ka kryer operacione të kërkim-shpëtimit, asgjësimit të mjeteve të pashpërthyera, zjarrfikjes dhe detyrat të tjera të caktuara të asistencës humanitare.

Forca e Sigurisë së Kosovës mund të krenohet me shumë arritje të realizuara brenda mandatit të saj të tanishëm.

Por, tash është koha të vazhdojmë tutje.

Tash është koha kur ne duhet të marrim përgjegjësinë e plotë për sigurinë e shtetit tonë.

E kjo do të nënkuptojë ndryshime të rëndësishme në mandatin, misionin, madhësinë dhe strukturën e saj.

Kjo do të thotë - një emër i ri për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Të nderuar oficerë të FSK-së,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Kjo është parada e fundit e ndërimit të Ditës së Pavarësisë, ku ne e shohim parakalimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës me emrin e saj të deritanishëm.

Na ndan një kohë shumë e shkurtër nga themelimi i Forcave të Armatosura të Kosovës.

Pra, një kohë shumë e shkurtër na ndan nga forca e re cila do t'i ketë kapacitetet e mbrojtjes dhe do ta ketë një mandat të ri, madhësinë dhe strukturën e re.

Forcat e Armatosura të Kosovës do të zhvillohen ashtu që të janë të gatshme dhe të afta ta mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

Forcat e Armatosura të Kosovës do t'i mbrojnë interesat e Kosovës, qytetarët e saj dhe pronën e tyre.

Forcat e Armatosura të Kosovës do të kontribuojnë për ndërtimin dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe atij global.

Aftësia që ne vet ta mbrojmë vendin tonë dhe t'i plotësojmë nevojat tona të sigurisë është, po ashtu, parakusht për integrimin e suksesshëm të Kosovës në strukturat veri-atlantike.

Që nga themelimi i FSK-së ju keni bërë një punë të jashtëzakonshme, prandaj sot edhe njëherë si kryeministër i Qeverisë së Kosovës, ju uroj dhe përgëzoj, për punën tuaj të jashtëzakonshme.

Të nderuar oficerë dhe ushtarë të FSK-së,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Edhe njëherë si kryeministër i vendit, në emër të Qeverisë së Kosovës, ju urojmë 6 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Zoti e bekoftë Kosovën dhe qytetarët e saj! Urime!"

Ambasadorja Trecy Jacobson: SHBA-të do të mbështesin gjithmonë Kosovën

Në përvjetorin e gjashtë të Pavarësisë së Kosovës, ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Prishtinë, znj. Trecy Jacobson, në fjalën e saj, ka lexuar letrën e presidentit Barak Obama për Kosovën, ku pos tjerash thotë, në gjashtë -vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, nisja e bisedimeve me BE-në për marrëveshjen e stabilizim-asocimit shënon edhe një të arritur të rëndësishme të Kosovës. Me këtë dialog udhëheqësit e Kosovës kanë thurë rrugën e Kosovës që do të përmirësojnë jetën e qytetarëve dhe do të çojë përpara synimet e saj drejt integrimeve evropiane" ndërsa, për sektorin e sigurisë, NATO-ja ka deklaruar se Forca e Sigurisë së Kosovës i ka arritur kapacitetet e plota operacionale dhe ka ndërmarrë përpjekje mbresëlënëse për rekrutimin e serbeve të Kosovës.

Në fund , ambasadorja Jacobson, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë të përkrahin dhe të mbështesin gjithmonë shtetin e Kosovës si të pavarur, sovran shumetnik dhe demokratik.



Presidentja Jahjaga: Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës dy institucionet më të besueshme për qytetarët e Kosovës

Ndërsa, presidentja e Kosovës, znj. Jahjaga, tha se, shpallja e Pavarësisë së Kosovës ka qenë akti më i rëndësishëm në historinë më të re të vendit që u ndërtua me idealin e gjeneratave të tëra që sakrifikuan për lirinë dhe demokracinë, për të shtuar se "Kjo është vepra më e larte e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës - të cilës vepër Ju i dhatë frymën dhe shpirtin dhe e bëtë të përjetshme, me idealin e tyre ata që bënë luftën - të gjithë ata burra e gra të UÇK-së, me komandantin legjendar Adem Jashari.

Në këtë gjashtë- vjetor të pavarësisë, dua në veçanti të shpreh mirënjohjen time për Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, këtyre dy institucioneve më të besueshme për qytetarët e Kosovës dhe institucioneve që dëshmojnë sa i palëkundshëm është sovraniteti ynë, po aq sa edhe vizioni ynë për integrim në NATO.

Suksesi i reformimit dhe profesionalizimit tuaj të mëtutjeshëm është i garantuar falë guximit, kurajës, durimit dhe zotimit për ta përmbushur misionin tuaj për një Kosovë paqësore dhe demokratike, për një shoqëri që ka për synim parësor investimin në sigurinë e çdo qytetari të saj dhe ku secili qytetar bashkëpunon me institucionet me besimin se ato ekzistojnë për t'i mbrojtur ata.

Jam e bindur se përkushtimi ynë për t'i ruajtur vlerat e idealet mbi të cilat u betuam dhe për të përforcuar dhe avancuar bashkëpunimin me aleatët tanë strategjikë, kurrë nuk do të vihet në dyshim.

Presidentja e Kosovës, ka falënderuar edhe miqtë tanë: " Dhe ne e kemi shkruar të tashmen tonë - në paqe - me ndihmën e miqve tanë ndërkombëtarë, si vullnet i përbashkët i yni dhe i të gjithë atyre që na kanë ndihmuar përgjatë gjithë historisë sonë. Në radhë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës por edhe vendet e Bashkimit Evropian".


Në fund presidentja Atifete Jahjaga, duke iu drejtuar qytetarëve të Kosovës, tha se: Ne kemi ende pune për të bërë në realizimin e ëndrrës së atyre që vendosën themelet e shtetit, duke treguar, sot, vendosmërinë për ta krijuar shtetin e së drejtës, të bazuar mbi rend dhe ligj që shtrihet në secilën pjesë të vendit, duke respektuar lirinë e secilit.

Në duar tona - qytetarë të Republikës së Kosovës - qëndron vetë suksesi i shtetit tonë. Në duart e të gjithë neve, njerëz të barabartë të këtij shteti, qëndron fuqia për ta bërë këtë vend një shembull të demokracisë së zhvilluar, ku gjithëpërfshirja nënkupton edhe obligim dhe përgjegjësi dhe gjithsesi mirëkuptim nga të gjithë.














Komandaniti i FSK-së gjeneral Kastrati dhe Komandanti i Gardës Kombëtare të Iowa-s gjenerali Orr, përcollën nga afër demonstrimin e shkathtësive taktike luftarake të FSK-së, në Pomozotin dhe Istog





Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Iowa-s, gjeneralmajorin Timothy Orr, së bashku me bashkëpunëtorë, më 14 shkurt, vizituan Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së, në Pomozotin dhe Brigadën për Reagim të Shpejtë në Istog.

Gjeneralët Kastrati dhe Orr u pritën nga stafi udhëheqës i RMC-së, kolonel Shaip Haziri dhe i BRSH-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, të cilët gjerësisht i njoftuan gjeneralët me aktivitetin e deritanishëm, trajnimet dhe të arriturat e përgjithshme.

Më pas të dy gjeneralët nga afër përcollën demonstrimet e shkathtësive taktike, të pjesëtarëve të FSK-së në Pomozotin, lëshimi me litarë dhe dhënia e ndihmës personave në nevojë, ndërsa në Istog pjesëtarët e BRSH-së demonstruan shkathtësitë e tyre taktiko-luftarake.







Në fund të dy gjeneralët u impresionuan me demonstrimin e shkathtësive të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët edhe i përgëzuan për përparimet dhe arritjet profesionale të tyre.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Iowa-s, gjenerali Orr, u pajtuan që së bashku t'i avancojnë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të IOWA-s, në shumë fusha me interes të përbashkët.

Komandanti i FSK-së gjeneral morri pjesë në ndërrimin e Komandës në Kampin Bondsteel

Më 13 shkurt 2014, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me ftesë zyrtare, mori pjesë në ceremoninë e organizuar me rastin e ndërrimit të komandës në Kampin Bondsteel.

Gjeneral Kastrati përcolli nga afër ceremoninë, dhe njëherësh përshëndeti KFOR-in për ndihmën e dhënë për FSK-në dhe Kosovën.

Me këtë rast, komandanti i Ushtrisë Amerikane David J. Woods, ia dorëzoi komandën Kolonelit të Ushtrisë Amerikane Charles T. Hansley.

Koloneli Woods, tha: "Për mua, puna në këtë mision ishte unike. Operacionet në mbështetje të paqes gjithmonë ndryshonin dhe çdo ditë përballesha me sfida të ndryshme".

Më pas, ai falënderoi njësitet vartëse dhe partnerët shumëkombësh, të cilët i ndihmuan atij, "të gjejë zgjidhje për sfidat" dhe "reflektuan pozitivisht" përkushtimin e tyre për vendet dhe ushtarët e tyre si dhe për popullin e Kosovës.

Koloneli Woods gjithashtu tha se ushtarët që përbëjnë rotacionin e 18-të të KFOR-it, do të jenë një "ekip dinamik" dhe shprehu bindjen e tij se ata do të ruajnë "standardet e larta profesionale që vijnë së bashku me të qenit pjesëtarë të këtij ekipi të lidhur fort".

Ndërsa, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajori Salvatore Farina, përmendi një listë të gjatë të të arriturave të KFOR-it 17-të, përfshirë krijimin e njësitit të përbashkët në pjesën veriore të Kosovës, e cila iu është përgjigjur 132 thirrjeve për ndihmë rreth mjeteve të pashpërthyera dhe ka kryer 23 misione për evakuime mjekësore me helikopter.

Ajo që është më e rëndësishme, theksoi Farina, është se ushtarët e rotacionit të 17-të të KFOR-it kontribuon në rritjen e ambientit të qetë dhe të sigurt në tërë Kosovën.





"Prania dhe veprimi juaj kanë kontribuar në masë të madhe për të pasur një ambient të qetë dhe të sigurt dhe liri të lëvizjes këtu në Kosovë", shtoi Farina. Për komandantin e sapoemëruar të Grupit Luftarak Shumëkombësh - Lindje, kolonelin Hensley, gjeneral Farina tha se detyrat e mëhershme ushtarake të Hensley-t do të shërbejnë si "parakushte më të mira për të pasur sukses në këtë mision të ndërlikuar".

Në fund të fjalës përmbyllëse, para një audience të përbërë nga disa qindra ushtarë nga kombe të ndryshme, udhëheqës ushtarak dhe mysafirë të ndryshëm, gjeneral Farina lavdëroi ushtarët e KFOR-it dhe tha se asnjë komandant nuk do të mund t'i kryente detyrat e komandimit pa pasur ushtarë të përkushtuar ndaj misionit në Kosovë.


"Më lejoni t'ju siguroj se kam qenë me ushtarë shumë herë në veri dhe në lindje, dhe mund t' ju them se ata janë ushtarë me vlerë të madhe dhe ata kanë bërë ndryshim të madh. Krenohem me punën që e kanë bërë. Krenohem shumë me ju, ushtarë të Grupit Luftarak Shumëkombësh - Lindje".

Nga Kapiteni i Ushtrisë Amerikane Kevin Sandell
Detashmenti i 11-të i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun

Në ministrinë për FSK u mbajt takimi me Komisionin Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikqyrje të FSK-së

Ministri Agim Çeku ishte nikoqir i takimit të udhëheqësve të MFSK-së dhe FSK-së, si dhe Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Në takim ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministrat Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, dhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i Komandës së Forcave Tokësore. Ndërsa Komisioni Funksional për Siguri i Kuvendit të Kosovës i kryesuar nga kryetari



Ahmet Isufi, si dhe anëtarët; Rexhep Selimi, Goran Marinkoviq, Ganimete Musliu, Anton Çuni, Fatmir Xhelili, Danush Ademi dhe Rasim Demiri.

Ministri Agim Çeku në fillim të takimit e njoftoi kryetarin Isufi dhe anëtarët tjerë mbi zhvillimet e deritanishme në FSK, për procesin nëpër të cilin po kalon ky institucion si dhe për rezultatet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Ministri Çeku,gjithashtu, edhe në cilësinë e shefit ekzekutiv të këtij procesi tha se na nevojitet mbështetja edhe e Komisionit Parlamentar për Siguri si edhe mbështetje e gjithanshme politike për synimet tona, lidhur me këtë proces.

Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj paraqiti një raport të punës dhe të arriturave për vitin 2013 si edhe objektivat e ministrit për vitin 2014.

Nga ana e tyre anëtarët e Komisionit Funksional për Siguri të Kuvendit të Kosovës shprehen interesim dhe parashtruan një varg pyetjesh që kishin të bënin me rekomandimet e procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Në fund kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Ahmet Isufi u shpreh se vazhdimisht ka qenë i kënaqur me të arriturat e ministrisë dhe FSK-së, dhe se në emër të Komisionit që ai drejton ofroi mbështetje të gjithanshme në kuadër të detyrës, që procesi nëpër të cilin po kalon FSK-ja të përmbyllet me sukses.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës bashkoi femrat e të gjitha institucioneve të sigurisë së vendit në një tryezë pune në MFSK

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), përkatësisht Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MFSK, organizuan me 13 shkurt 2014 takimin zyrtar, me qëllim të thëllimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e sigurisë, përkatësisht femrat që shërbejnë në uniformë, si edhe promovimin e barazisë gjinore në të gjitha institucionet e sigurisë së Kosovës. Të pranishëm në takim ishin edhe ministri i MFSK-së, Agim Çeku dhe sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj.

Ministri Çeku, fillimisht përshëndeti të pranishmet dhe i uroi për iniciativën e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, duke iu ofruar atyre mbështetje të mëtutjeshme





në fuqizimin dhe vendimmarrjen e femrave në institucionet e Kosovës. A ndër të tjera në fjalën e tij tha: "E çmoj lart kontributin e femrës në FSK, e cila në përqindje është më e kënaqshme se në disa vende të NATO-s, por ne do të bëjmë edhe më shumë që të kemi progres edhe më të madh në ngritjen e kësaj përqindjeje si dhe në avancimin e femrës në institucionin tonë. Femrat në FSK po luajnë rol të jashtëzakonshëm në afirmimin e FSK-së, si forcë gjithëpërfshirëse, e cila po ngrihet dhe ndërtohet sipas standardeve të NATO-s" përfundoi ministri Çeku.

Nikoqiri i këtij takimi major Remzie Zeqiraj, oficere për Marrëdhënie me Publikun, në fjalën e saj të rastit theksoi arsyet se pse është i rëndësishëm bashkëpunimi ndërmjet femrave që shërbejnë në institucionet e sigurisë, e ne veçanti atyre qe shërbejnë në uniformë. Major Zeqiraj gjithashtu tha: "Jemi ne që vullnetarisht dhe me kënaqësi bartim këtë uniformë nëpërmjet se cilës identifikohemi me institucionin duke bartur kështu simbolet e shtetit tone. Më tej major Remzie Zeqiraj tha: "Shërbimi ynë përkundër që është përgjegjësi dhe sfidë, njëkohësisht është edhe kënaqësi dhe krenari për ne qe kemi marr obligim të kujdesemi për imazhin e institucionit dhe shtetit"

Major Zeqiraj prezantoi para të pranishmëve edhe temën "Kontributi dhe perspektiva e femrave në MFSK" ku theksoi se femrat e angazhuara në MFSK dhe FSK tani shërbejnë në detyrën e ushtarit, nënoficerit dhe oficerit, kryejnë me përgjegjësi urdhrat që jepen nga zinxhiri komandues, pavarësisht statusit të tyre social dhe angazhimit familjar, ja dalin të jenë në hap me kolegët në të gjitha angazhimet në punë. Ajo tha se femrat në MFSK dhe FSK, tani më kanë ndërtuar një përvojë, e kanë përgatitjen shkollore dhe ngritjen profesionale të nevojshme për të qenë të suksesshme dhe produktive në punë. Kanë arritur që të jenë aktive dhe në ngritje profesionale me trajnime të nevojshme dhe adekuate për detyrat. "Pjesëtaret e FSK-së kudo ku janë paraqitur, si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit, janë dalluar në trajnime dhe operacione. Ushtaraket tona janë të përkushtuara në zbatimin e detyrave, respektimin e zinxhirit komandues dhe gjithsesi aplikojnë edhe kreativitetin si dhe vetiniciativën duke dhënë kontribut në profile specifike si mjekësi, deminim, kërkim-shpëtim, reagim të shpejtë, logjistikë, polici, financa, marrëdhënie publike, marrëdhënie ushtarake-civile, inteligjencë, administratë, etj" Po ashtu femra në FSK është e angazhuar me detyra edhe në zinxhirin komandues, pra komandante, zëvendëskomandant, si dhe udhëheqëse departamentesh e sektorësh" përfundoi major Zeqiraj.

Po ashtu edhe zonja Halime Morina, shefe e Njësisë për të Drejtat e Njeriut, për të pranishmet prezantoi temën "Perspektiva gjinore në MFSK dhe FSK", ku ndër të tjera tha se është një dimension jetësor, tashmë i shtrirë në politika dhe plane të zbatimit në të gjitha nivelet, në të gjitha njësitet, brigadat, batalionet, departamentet, sektorët dhe zyrat. Duke u përqendruar në fushën e sigurisë, roli i grave gjithnjë e më shumë po bëhet i rëndësishëm si në: operacione, menaxhimin e krizave të mundshme, vendimmarrje etj. Ajo ndër të tjera u shpreh: " Numri i femrave në pozita vendimmarrëse në MFSK ka një ngritje të konsiderueshme. MFSK-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë pjesëmarrjes së femrave në pozita vendimmarrëse, ku aktualisht përqindja e femrave të personelit civil në MFSK është 33.06%, kurse me uniformë 8.09% përkatësisht 183 femra në uniformë në gradën e oficerit dhe nënoficerit".

Në takimin e femrave që shërbejnë me uniformë në institucionet e sigurisë se vendit, me temën: "Kontributi dhe perspektiva e femrave në Forcat e Armatosura të Letonisë" u paraqit këshilltarja e NATO-s për FSK, zonja Vineta Kleine. Ajo bëri edhe një krahasim ndërmjet përvojave të ushtarakeve të FSK-së dhe atyre të Letonisë, duke qenë njohëse e mirë tanimë edhe e rrethanave në FSK dhe Kosovë.

Nga ky takim ku pjesëmarrëse ishin përfaqësueset e MFSK-së dhe FSK-së, Policisë së Kosovës, Shërbimit Doganor, Shërbimit Korrektues, Shërbimit Sprovues, u diskutuan modalitetet e bashkëpunimit, si dhe u propozuan disa ide konkrete për bashkëpunim të cilat u vendos që të diskutohen në secilin prej institucioneve pjesëmarrëse veç e veç, në mënyrë që bashkëpunimi të konkretizohet. Secili institucion të ndërtojë asociacionin; asociacionet të ndërtojnë një trup të përbashkët koordinues; bashkëpunimi të vazhdohet me përfaqësim të tri rangjeve më të larta të femrave në uniformë të të katër institucioneve, që do të përbënte një lloj trupi koordinues të përbashkët; bashkëpunimin ta koordinojnë Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe ajo për Barazi Gjinore.



Certifikohen 25 kadetë të FSK-së, në Kërkim-Shpëtim në Dimër







Për një muaj rresht 25 pjesëtarë të FSK-së, kanë kryer një trajnim të kërkim-shpëtimit në kushte dhe rrethana dimri. Pjesa teorike është kryer në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në hapësirat e Qendrës Specialistike të Stërvitjes në Ferizaj, ndërsa pjesa praktike në terrenet e improvizuara malore, në malet e fshatit Strazhë të Komunës së Kaçanikut.

Ky trajnim është realizuar në kuadër të planit kalendarik të trajnimeve, që e ka planifikuar Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së. Trajnimi ka filluar më 20 janar dhe ka përfunduar më 21 shkurt 2014.

Trajnimi është realizuar nga instruktorët e Qendrës Specialistike të Stërvitjes (QSS) të FSK-së, të cilët me sukses kanë



trajtuar temat lidhur me menaxhimin e kërkim-shpëtimit në dimër, topografinë dhe ndihmën e parë.

Pjesa praktike e kërkim-shpëtimit në dimër, ka qenë shumë sfiduese për pjesëtarët e FSK-së dhe për instruktorët të cilët e kanë ndjekur këtë kurs.

Edhe përkundër sfidave dhe terrenit mjaft të vështirë, kadetët janë dalluar me angazhimin e tyre maksimal në realizimin me sukses të këtij trajnimi. Ata kanë qenë mjaft të motivuar dhe të angazhuar, edhe pse kursi ishte i mbyllur, ritmi i angazhimeve nuk ndryshoi asnjëherë për 30 ditë sa zgjati pjesa teorike dhe praktike, si në hapësirat e Qendrës Specialistike të Stërvitjes, po ashtu edhe në malet e fshatit Strazhë. Kjo ishte një garë brenda ekipeve për të arritur më të mirën nga kursi.

Vlen të theksohet se njohuritë e marra nga ekipet e NATO-s, instruktorët e FSK-së, me sukses po i praktikojnë në terren, për t'i përgatitur profesionalisht pjesëtarët e të gjitha njësive të FSK-së, jo vetëm në kërkim-shpëtim në dimër, por edhe në disiplina të tjera.

Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë oficerët e stafit udhëheqës, të cilët për kadetët ndanë "certifikata" për kryerjen me sukses të trajnimit të kërkim-shpëtim në dimër.

Trajnim i suksesshëm i pjesëtarëve të FSK-së në Kampin e KFOR-it Gjerman në Prizren

Në Kampin Gjerman në Prizren, ditë më parë, ka përfunduar me sukses trajnimi i mbajtur, në organizim të NLAT-it dhe në bashkëpunim me; J1/G1, të MFSK-së dhe KFT-së, ku koordinator i FSK-së ishte kolonel Bajram Uka.

Qëllimi i trajnimit, sipas kolonelit Uka, ishte identifikimi i fushave të personelit si: sfidat e tanishme, mënyrat e bashkëpunimit në mes NLAT-it dhe J1/G1 të FSK-së, në të ardhmen, etj. Nevoja për diskutim ndërmjet MFSK-së dhe KFT-së për të krijuar një urë bashkëpunimi në nivelin strategjik dhe operacional, kërkesat për këshillim dhe mbështetje në fusha të caktuara, etj.

Në këtë drejtim, për punë profesionale dhe angazhim maksimal u dallua koloneli gjerman Alfred Marstellar, për përgatitjen, trajnimin dhe akomodimin, gjatë kohës së mbajtjes së trajnimit, në Kampin Gjerman në Prizren.

Pjesëtarët e J1/G1 të MFSK-së, FSK-së, janë njoftuar edhe me temat që kanë të bëjnë me funksionimin e personelit (në Kampin Gjerman), detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme si dhe përvojat e ndryshme nga menaxhimi i burimeve njerëzore duke marr në shqyrtim modelet e shteteve të ndryshme, pastaj për detyrat dhe përgjegjësitë e personelit gjatë përgatitjeve të njësive për operacione dhe zbarkim jashtë vendit, si dhe për temat, kujdesin, mbështetjen dhe mirëqenien e personelit në operacione jashtë vendit.

Të gjithë pjesëmarrësit gjatë trajnimit, temat e mësuara, praktikisht i kanë ushtruar në Kampin



Gjerman, në grupe dhe në mënyrë individuale.

Në fund, të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata për pjesëmarrjen dhe arritjen e rezultateve në trajnim.







Një tog i FSK-së udhëtoi për një trajnim të specializuar në Turqi


Më 23 shkurt, në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), është rreshtuar një tog i FSK-së, prej 22 pjesëtarësh të Brigadës për Reagimit të Shpejtë, (BRSH) me gradën nëntoger-ushtar, të cilët udhëtuan për një trajnim të specializuar në Turqi.

Qëllimi i këtij trajnimi është përgatitja e pjesëtarëve të FSK-së, në mënyrë sa më profesionale, për përballjen me dimër të ftohtë dhe me acar. Trajnimi në poligonet ushtarake të Turqisë, "Mbijetesa në dimër të ftohtit dhe të ashpër", do të mbahet nga 23 shkurt 2014 deri më 08 mars 2014.

Ky trajnim si dhe trajnimet e mëparshme të pjesëtarëve të FSK-së, në poligonet e Ushtrisë së Turqisë, po realizohen në bazë të Memorandumit të bashkëpunimit dypalësh në mes MFSK-FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë dhe Ushtrisë së Turqisë.

Për të përcjellë ushtarët e FSK-së, kishin ardhur shefi i Shtabit të KFT-së kolonel Naim Haziri dhe shefi i Shtabit të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), nënkolonel Jeton Dreshaj, si dhe përfaqësuesi i Ushtrisë së Turqisë.

Me këtë rast, koloneli Naim Haziri u shprehë se ndjehet tejet i lumtur



që Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Turqisë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë së Turqisë, kanë ofruar mundësi trajnimi për FSK-në, për trajnimin "Mbijetesën në dimër të ftohtë dhe të ashpër", dhe kjo po ndodh pikërisht në repartet dhe poligonet ushtarake të Ushtrisë së Turqisë, tha kolonel Haziri, cili pastaj i përshëndeti të gjithë pjesëtarët e FSK-së, për të shprehur bindjen e tij, se gjatë këtij trajnimi pjesëtarët e FSK-së, do të arrijnë që ta përfaqësojnë denjësisht FSK-në, sikurse edhe herëve tjera.

Në fund, kolonel Haziri kërkoi nga ushtarët e FSK-së, që gjatë trajnimit të përfitojnë sa më shumë njohuri nga Ushtria e Republikës së Turqisë, si dhe këto njohuri t'i zbatojnë, pastaj, me përpikëri në njësitet e tyre në FSK.

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 22 • Shkurt 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën admiralin e NATO-s, Bruce Clingan



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 4 mars, pritën në ambientet e ministrisë komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara të NATO-s, admiralin Bruce W. Clingan.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, e informoi admiralin Clingan për zhvillimet e fundit, gjithashtu edhe për vendimin e Qeverisë për të ardhmen e FSK-së. Ai theksoi faktin se këto zhvillime të reja janë në interes të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare.


Ministri Çeku e siguroi admiralin Clingan se FSK-ja do të vazhdojë t'ju shërbejë të gjithë qytetarëve të saj, si një forcë për të mirë në rajon, e cila do të zhvillohet sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Nga ana e tij admirali Clingan përgëzoi ministrin e FSK-së për të gjitha të arriturat dhe për punën e mirë në mbështetjen e të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Ministri Çeku e falënderoi admiralin Clingan për mbështetjen që NATO-ja i ka dhënë MFSK-së dhe FSK-së përmes Ekipit Ndërlidhës Këshillues, si dhe për punën e shkëlqyer të KFOR-it si një forcë stabilizuese në Kosovë, Ai njëherësh kërkoi nga komandanti i Komandës së Forcave të Bashkuar të NATO-s që të vazhdojë ta mbështetës Kosovën dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Shefi i Shtabit të FARSH-së, gjenerali Bazo vizitoi MFSK-në

Bashkëpunim i ngushtë në mes Ushtrisë së Shqipërisë dhe FSK-së



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, priti më 18 mars, në ambientet e Ministrisë shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura (FA) të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Jeronim Bazo si dhe delegacionin e lartë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Shqiptare. Shefi i Shtabit të FA-së të Republikës së Shqipërisë u prit me nderime të larta nga Togu Ceremonial i FSK-së.

Gjeneralmajor Bazo dhe oficerët e tjerë të lartë të FA-së të Republikës së Shqipërisë zhvilluan takime të ndara me ministrin e FSK-së, z. Agim Çeku dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, dhe pastaj të dy delegacionet mbajtën takim të përbashkët.

Të dy gjeneralët; Kastrati dhe Bazo në deklaratat për shtyp folën mbi raportet shumë të mira dhe vëllazërore ndërmjet dy institucioneve, si dhe për gatishmërinë e tyre për t'i ofruar ndihmë njëratjetrës. Gjenerallejtënant Kadri Kastrati me këtë rast tha se kam kënaqësinë e veçantë që sot prita shefin e Shtabit të FA-së të Shqipërisë, gjeneralin Bazo, për një vizitë, e cila tregon për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet dy forcave tona.

"Ne me gjeneralin Bazo dhe delegacionin shqiptar biseduam për vazhdimin e bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet nesh, por edhe në regjionin në kuadër të konceptit të NATO-s".

Gjithashtu e informova gjeneralin Bazo edhe për kapacitet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe për ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Kosovës, ku jemi duke punuar që sa ma shpejtë t'i krijojmë këto kapacitete. Ne kemi nevojë për bashkëpunimin dhe përkrahjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që edhe në të ardhmen të na ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve tona. Po ashtu biseduam edhe për projektet e përbashkëta, sepse objektivi ynë është që Forcat e Armatosura të Kosovës të jenë edhe pjesë e familjes së NATO-s. Meqenëse FA të Republikës së Shqipërisë janë anëtare të NATO-s , atëherë eksperienca e tyre do të na shërbej që ne ta kalojmë atë rrugë sa më shpejtë që është e mundur dhe të jemi aktiv aty.

Në fund, gjeneral Kastrati falënderoi shefin e Shtabit të FA-së të Shqipërisë, gjeneralin Bazo, për gatishmërinë e tij dhe të Shtabit të Përgjithshëm për ofrimin e ndihmës për ngritjen profesionale të FSK-së.

Ndërsa, gjeneralmajori Jeronim Bazo, fillimisht falënderoi komandantin dhe ministrin e FSK-së për pritjen, si edhe shprehu gatishmërinë e FA-së për ta ndihmuar FSK-në edhe në të ardhmen në të gjitha drejtimet, duke qenë së FA-të të Shqipërisë janë edhe anëtarë me të drejta të plota në NATO.

"Vetë vizita ime, rikonfirmoi që është një hap i ri i marrëdhënieve ekzistuese të shkëlqyera që ekzistojnë midis dy vendeve dhe FA të Republikës së Shqipërisë dhe FSK-së. Unë jam shumë i gëzuar që u ndodha në këtë vizitë në një moment tepër të rëndësishëm dhe interesant, sfidues dhe frytdhënës në historinë e zhvillimit të FSK-së. Ky është një moment i rëndësishëm që hap shpresë për një rrugëtim të ri, për rritjen e kapaciteteve dhe rritjen e bashkëpunimit dy palësh me vendet si Shqipëria dhe të tjerat.

Gjeneral Bazo, në fund premtoi : "Forcat tona të Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes dhe Republika e Shqipërisë në përgjithësi do të angazhohen seriozisht për të dhënë një impuls të ri marrëdhënieve dypaleshe, duke u përqendruar në bashkëpunimin e mirëfilltë në fushën e arsimimit dhe në fushën e trajnimit ushtarak, si dhe duke ndarë përvojën tonë modeste në fushën e integrimit euroatlantik. Për fat të mirë kemi një vullnet politik për të ecur në këtë rrugë të bashkëpunimit dypalësh" tha në fund, shefi i Shtabit të FA-së të Republikës së Shqipërisë gjeneralmajor Jeronim Bazo.

Në pritjen e delegacionit ushtarak të FA-së të Republikës së Shqipërisë morën pjesë gjeneralët: Bashkim Jashari (inspektor gjeneral i FSK-së) Gëzim Hazrolli, (zëvendëskomandant i Komandës së Forcave Tokësore) Enver Cikaqi, (komandant i KDS-së) dhe nënkolonelët: Hasan Hoxha, Rifat Sylemani dhe Agron Bajrami. Ndërsa, delegacioni i Shqipërisë përbehej nga, kolonel Arben Toska, kolonel Idriz Haxhia, kolonel Nazmi Cahani dhe kapiten Evis Tollja.

Delegacioni i Ushtrisë Shqiptare pas vizitës në Ministrinë e FSK-së vizitoi Qendrën për Studime Universitare të FSK-së dhe Regjimentin e Mbrojtjes Civile, ku gjeneralmajor Bazo zhvilloi takime me stafin e lartë të KFT-së dhe të RMC-së.


Kontraadmirali Odd Werin, shefi i delegacionit të Suedisë në NATO, vizitoi ministrinë për FSK

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 25 mars, pritën në ambientet e Ministrisë shefin e delegacionit të Suedisë në NATO, kundëradmiralin Odd Werin me bashkëpunëtorë.

Ministri Çeku falënderoi admiralin Werin për bashkëpunimin e shkëlqyer që MFSK-ja ka me shtetin e Suedisë, për shërbimin e kontingjentit të Forcave të Armatosura të Suedisë në kuadër të KFOR-it në Kosovë, për mbështetjen e pakursyer të këshilltarëve suedez në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s (NAT) për ministrinë e FSK-së, pastaj, në fushën e bashkëpunimit ushtarako-civil, në fushën e drejtave të njeriut, në fushën humanitare (deminim) dhe në fusha tjera.

(vijon në faqen e 7)

Gjeneralë të Ushtrisë së Turqisë vizituan FSK-në



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 21 mars, priti në Ministri një delegacion të lartë të gjeneralëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në krye me gjenerallejtënant Musa Avsaver, shef i komunikimit në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Turqisë (FART).

Komandant Kastrati e njoftoi delegacionin e Forcave të Armatosura të Turqisë mbi zhvillimin e FSK-së, operacionalizimin, kapacitetet, trajnimet, mbështetjen për komunitetin si dhe aktivitetet humanitare. Po ashtu, gjeneral Kastrati shprehu edhe falënderimin për mbështetjen dhe përkrahjen që FARKT i ka dhënë FSK-së, gjatë procesit të ngritjes së kapaciteteve të plota operacionale.(vijon në faqen 2)

Ministri Agim Çeku priti ambasadorin e ri të Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi



Ministri i FSK-së, Agim Çeku, priti ambasadorin e ri të Republikës së Shqipërisë, z. Qemal Minxhozi, i cili kohë më parë është emëruar ambasador në Republikën e Kosovës. Në pritje morën pjesë edhe zëvendësministrat; Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi. Ministri Çeku, fillimisht, z. Minxhozi i uroi detyrën e re dhe më pastaj e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar që ka FSK-ja. Me theks të veçantë ai foli për bashkëpunimin e ngushtë në mes të dy ministrive; asaj të Mbrojtjes së Shqipërisë dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës.
Ndërsa, ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Minxhozi duke falënderuar ministrin Çeku për pritjen e ngrohtë, rikonfirmoi vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në mes dy shteteve. Vizita e ambasadorit të Shqipërisë në MFSK kishte karakter njohës.

Thellimi i bashkëpunimit në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK), për vizitë zyrtare, më 17 mars, qëndroi një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, në përbërje: z. Bekim Maksuti, shef i Divizionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar (udhëheqës delegacioni), znj. Minevere Leskovica, këshilltare ligjore në Kabinetin e Ministrit të Mbrojtjes së Maqedonisë dhe z. Blerim Ukalli, nga Kabineti i Ministrit të Mbrojtjes së Maqedonisë.
Delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë u prit nga kolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK, znj. Krenare Sogojeva drejtoreshë e Departamentit Ligjor dhe Petrit Ajeti zyrtar i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri .
Pas takimit në mes të dy delegacioneve u nënshkrua "Plani dypalësh për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes për vitin 2014". Në emër të Ministrisë së FSK-së, planin e nënshkroi drejtori i Departamentit për Bashkëpunim, kolonel Hasan Hoxha, ndërsa në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë, z. Bekim Maksuti, shef i Divizionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar.
Me këtë plan janë paraparë shkollimi i kadetëve të FSK-së në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë, pastaj organizimi i trajnimeve për pjesëtarët e FSK-së në institucione të arsimimit ushtarak të Republikës së Maqedonisë, si dhe vizita të ndërsjella me karakter të shkëmbimit të përvojave ndërmjet dy ministrive.

Në përvjetorin e 15 të intervenimit të NATO-s, në Kosovë

Ligjëratë e ministrit Çeku në Universitetin Publik "Haxhi Zeka" në Pejë



Në 15- vjetorin e fillimit të intervenimit të NATO-s kundër forcave ushtarake të Serbisë, ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, më 24 mars, para profesorëve dhe studentëve të universitetit publik "Haxhi Zeka"në Pejë, mbajti një ligjëratë me temën: "15 vjet pas intervenimit të NATO-s në Kosovë". Interesimi i studentëve dhe profesorëve për të përcjellë ligjëratën e ministrit Çeku ishte shumë i madh. Para studentëve dhe profesorëve ministri Çeku tha:Këtu para 15 vjetëve ishte kazermë ushtarake, ndërsa sot është universitet i dijes. Nga këtu është rast i mirë që edhe një herë të falënderojmë NATO-n, për gjithë mbështetjen që i kanë dhënë dhe po i japin Kosovës. NATO-ja për ne është më shumë se sa një Aleancë Ushtarako-Politike, ajo është simbol i lirisë, pavarësisë, sigurisë dhe mbrojtjes tonë. NATO-ja ka qenë përkrah nesh si në TMK ashtu edhe , në FSK. Ne kemi një bashkëpunim të mirë edhe me KFOR-in, ku tani me ne punojnë dy ekipe këshilluese të NATO-s.
Gjithashtu, ministri Çeku i njoftoi studentët se gjatë luftës ka pasur mbi 38000 fluturime, me gjithsej 1055 aeroplanë, ndërsa vetëm gjysma e tyre kanë qenë nga (700 aeroplanë) nga SHBA-të. Ai foli edhe për mësimet e nxjerra nga fushata ajrore, e cila nuk duhet të jetë model për krizat e mundshme në të ardhmen , duke vazhduar më tej fjalimin e tij, ministri Çeku, shtoi: "Të gjithë e dinin se Millosheviçi, kishte vendosur ta zgjidhte problemin "një herë e përgjithmonë", me luftë të ndryshonte balancën etnike në Kosovë dhe të shkatërronte UÇK-në. Këtë e dëshmoi edhe fushata ushtarake që ndërmori Serbia, siç ishte Operacioni "PATKOJ".
Ndërsa, për UÇK-në, tha se u bë pjesë e zgjidhjes vetëm në fund të vitit 1998 pasi që ajo u ringjall dhe me ardhjen e misionit verifikues bashkësia ndërkombëtare e kishte situatën më të qartë në terren. Operacioni i NATO-së, ishte i suksesshëm, me sulmet ajrore nuk synohej shkatërrimi i potencialit ushtarak të Millosheviçit, por dobësimi i vullnetit të tij, për t'i rezistuar presionit të bashkësisë ndërkombëtare. Operacionet e NATO-s, kishin për qëllim shkatërrim e sistemit kundërajror, komandës,kontrollit dhe komunikimit (aeroportet, radarët, bazat raketore, mjetet e komunikimit, postat, komandat, kazermat).
Një tjetër faktor i dobësimit të Millosheviçit ishte humbja e përkrahjes së Rusisë, e që ishte një ndër faktorët që çoi Serbinë drejt kapitullimit. Në fund, studentët dhe profesorët i shtruan shumë pyetje ministrit, të cilat kryesisht kishin të bënin me zhvillimin e Kosovën, themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, zhvillimin dhe profesionalizimin e saj, etj.

Gjeneralë të Ushtrisë së Turqisë vizituan FSK-në

(Vijon nga faqja parë)

Gjenerallejtënant Musa Avsaver, shef i Komunikimit në Shtabin e Përgjithshëm të FART, u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit të deritanishëm me FSK-në, dhe njëkohësisht shprehu gatishmërinë për bashkëpunim edhe më të gjerë në të ardhmen në fushën e mbrojtjes.
Në takimin e përbashkët të dy delegacioneve, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli bëri një prezantim për të arriturat e FSK-së, si edhe i njoftoi të pranishmit mbi procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Kosovës dhe për rekomandimet që kanë dalë nga ky proces. Delegacionin e Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë e priti në takim edhe ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë, zotëri Agim Çeku. Gjatë takimit, ministri Çeku i njoftoi mysafirët për procesin nëpër të cilin po kalon FSK-ja, në drejtim të krijimit të Forcave të Armatosura të Kosovës, si dhe përmendi një varg temash në të cilat Republika e Turqisë mund dhe ka kapacitet ta mbështes Kosovën. Gjithashtu ministri Çeku lavdëroi punën e kontingjentit turk në kuadër të KFOR-it, si edhe punën e këshilltarit ushtarak turk në ministri dhe mbështetjen e instruktorëve turq në FSK.
Nga ana e tij gjenerallejtënant Musa Avsaver, kryesues i delegacionit u shpreh se është i lumtur që FSK-ja po përmbyll me sukses misionin dhe se po hapet një kapitull i ri për Kosovën në fushën e mbrojtjes. Ai tha se ashtu si edhe i gjithë populli turk, edhe Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë iu gëzohen të arriturave dhe suksesseve të vendit tuaj.
Në përbërje të delegacionit të FA-së të Turqisë ishin edhe: gjenerallejtënant Sezai Bostanci, nënsekretar i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, gjeneralmajor Mustafa Ozsoy, shef i Departamentit të Kundërzbulimit, Inteligjencës dhe Sigurisë, gjeneral major Gursel Ozturk, zëvendës i nënsekretarit të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, gjeneral brigade Riza Cagatay Erdogan, shef i Departamentit të Inxhinierisë, kolonel Zorlu Topaloglu nga Komanda e Kontingjentit Turk, kolonel Erdal Dodurga, këshilltar i komandantit të FSK-së dhe kolonel Hasan Aydogdu, atashe ushtarak i Republikës së Turqisë i akredituar në Kosovë.
Ndërsa në pritje të delegacionit turk nga FSK-ja ishin të pranishëm edhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Bashkim Jashari, shef i Inspektoratit të FSK-së, gjeneral brigade Ilaz Derguti, komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale, kolonel Skender Zhitia, shef i Departamentit të Personelit dhe nënkolonel Hasan Hoxha, ushtrues detyre i shefit të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK.
Ministria për FSK dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë që nga 24 dhjetori i vitit 2009 e kanë të nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, e cila i ka të rregulluara të gjitha fushat e bashkëpunimit .

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Në Kazermën "Adem Jashari" të FSK-së, në Prishtinë

Ministri Çeku e njoftoi stafin e lartë të MFSK-së, për vendimin e Qeverisë për krijimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Kosovës

Ministri i MFSK-së, Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 04 mars, mbajtën një takim të përbashkët me stafin e lartë të Ministrisë dhe të FSK-së, në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), ku Ministri Çeku i njoftoi të pranishmit për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës dhe të Ministrisë së Mbrojtjes.



Ministri Çeku, me këtë rast, i njoftoi oficerët e FSK-së dhe stafin civil të ministrisë lidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, si edhe për procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë prej të cilit kanë dalë edhe rekomandimet e aprovuara në Këshillin e Sigurisë.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, duke shtjelluar konceptin e ri shtoi: "Forcat e Armatosura të Kosovës do t'i kenë pesë mijë ushtarë aktiv dhe tre mijë rezervë. Si pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes do të jetë shefi i Mbrojtjes, i cili njëkohësisht do të jetë Komandat i Forcave të Armatosura të Kosovës, kurse Komandant Suprem do të jetë Presidentja e Kosovës" tha ndër të tjera ministri Çeku.

Ministri Agim Çeku, njoftoi të pranishmit me detyrat e Forcave të Armatosura të Kosovës që do të jenë: mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, mbështetja e autoriteteve civile, mbështetja e komuniteteve, si dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare në mbështetje dhe ruajtje të paqes.

Më pas në fjalën e tij ministrit Çeku, në pika të shkurtra, foli për strukturën dhe misionin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Në fund të takimit ministri Çeku u përgjigj në një varg pyetjesh të parashtruara nga oficerët e FSK-së dhe nga stafi civil i MFSK-së .

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati i kënaqur me trajnimin e FSK-së, për "Doktrinën për të Ardhmen"

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, së bashku me zëvendëskomandantin e KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrollin dhe atasheun ushtarak të SHBA-s në Prishtinë, kolonelin James Kott, më 7 mars qëndruan për një vizitë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, ku u pritën nga komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi.

Qëllimi i kësaj vizite ishte përcjellja nga afër e trajnimit për përgatitjen e "Doktrinës për të Ardhmen", ku në hollësi për zhvillimet e këtij trajnimi u njoftuan nga gjeneral brigade Enver Cikaqi. Trajnimi është mbajtur nga data 3 mars deri më 7 mars 2014, ku morën pjesë 19 pjesëtarë të lartë nga të gjitha njësitë e FSK-së, dhe është realizuar nga ekspertët e Drejtorisë së Doktrinës Amerikane, James Benn dhe Michael Scully, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm si pjesë e grupit punues.

Trajnimi për përgatitjen e "Doktrinës për të Ardhmen" është vlerësuar lart dhe është cilësuar si mjaft frytdhënës si nga ana e pjesëmarrësve po ashtu edhe nga ana e ligjëruesve. Kontribut të veçantë në këtë seminar ka dhënë edhe Ekipi Ndërlidhës Këshillëdhënës i NATO-s (NLAT).

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, së bashku me delegacionin e tij përcollën paraqitjen e shkurtër të mbajtur nga James Benn, zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Doktrinës Amerikane.

Pjesa e parë e trajnimit u finalizua me sukses nga oficerët e FSK-së, pjesëmarrës në këtë trajnim, të cilët ishin shumë të entuziazmuar gjatë periudhës sa kanë punuar bashkë, tha në fund të fjalës së tij përmbyllëse z. James Benn.

Ndërsa, komandanti FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati ,fillimisht falënderoi ekipin e ekspertëve amerikan, grupin punues dhe NLAT-in , për punën e përkushtuar në përgatitjen e "Doktrinës për të Ardhmen".

Gjeneral Kastrati, më tej, tha se ndjehet krenar për punën kaq voluminoze që është bërë për një kohë të shkurtër, të cilën e shef si rezultat të ekipit amerikan.

Ai kishte edhe një porosi për grupin punues të FSK-së, duke kërkuar nga ata që mësimet e nxjerra dhe obligimet që dalin nga ky seminar t'i



vejnë në zbatim me sukses.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, më tej, shtoi:" Jam i sigurt se në takimin e radhës do t'i shohim rezultatet e para të kësaj pune të cilën e vlerësoj lartë, e që ka qenë edhe një sfidë të cilën e kemi kaluar me sukses.

Në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati dhe komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, për ekspertët amerikan, z. James Benn dhe Michael Scully, për punën dhe kontributin e tyre gjatë këtij trajnimi ndanë mirënjohje dhe medalje.

Komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi vizitoi Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Shqipëri

Komisioni për bashkëpunim dhe koordinim i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i përbërë nga gjeneral brigade Enver Cikaqi, Shemsi Syla, nënkolonel Enver Dugolli dhe Petrit Ajeti, më 3 mars, qëndruan për një vizitë zyrtare pune në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Shqipëri, ku u pritën nga koloneli Ruzhdi Kuçi dhe stafi i lartë i KDS-së.

Vizita e delegacionit të FSK-së, pati për qëllim organizimin e diskutimeve mbi vendosjen e piketave të përbashkëta, në drejtim të unifikimit të arsimimit dhe trajnimit ushtarak midis dy vendeve, si dhe mbi dhënien e asistencës nga pala shqiptare për integrimin e FSK-së në NATO.

Në takimin ku merrnin pjesë grupet përkatëse të punës për diskutime të përbashkëta, kolonel Kuçi, pasi që i uron mirëseardhje delegacionit të FSK-së, e njohu gjeneral Cikaqin dhe ekipin e tij me zhvillimet e Forcave të Armatosura (FA), ecurinë dhe zhvillimet më të fundit për përmirësimin, zhvillimin dhe konsolidimin e të gjitha strukturave arsimore ushtarake, në kuadër të rishikimit dhe përmirësimit të procesit arsimor, programit të ri pilot të trajnimit të oficerëve të rinj nga Garda Kombëtare e New Jerseyt etj.

Më pas, duke folur për qëllimin që kjo vizitë kishte, kolonel Kuçi ndër tjerash u shpreh:" Bashkëpunimet dypalëshe të nisura më herët, kryesisht në fushën e arsimimit ushtarak, nëpërmjet përfshirjes në kurset institucionale të oficerëve të Kosovës, si në KLSM, KLO, KKSHP kanë qenë tepër produktive. Kemi arritur në një shtysë të re të marrëdhënieve tona, me projekte ambicioze dhe të insitucionalizuara. Bashkëpunimi dypalësh do të konsolidohet në të gjitha fushat;



grupet e punës janë krijuar për këtë qëllim, si dhe për të krijuar projekte të reja në kuadër edhe të "Smart Defense" ka përfunduar fjalën e tij, komandanti i KDS-së, kolonel Kuçi.

Nga ana e tij, gjeneral brigade Enver Cikaqi, pasi që falënderoi palën shqiptare për mikpritjen e ngrohtë, e njoftoi edhe rreth punës që po bëhet në sistemin arsimor ushtarak që po realizohet në Task-Qendrën Trajnuese të KDS-së. Ndër të tjera ai u shpreh " Shkolla ka nxjerrë e po nxjerr kuadro shumë të përgatitur e që kanë arritur të japin rezultate pozitive në punën e tyre.

Megjithatë, shkëmbimi i ideve dhe marrja e eksperiencave tuaja në të gjitha fushat përveçse rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit në sistemin e mbrojtjes së të dy vendeve do t'i shërbejnë më së miri edhe përmirësimit dhe funksionimit pozitiv e sipas standardeve edhe të punës konkrete që bëhet në institucionin tonë, atë të Komandës dhe Doktrinës. Me përkrahjen, ndihmën, sugjerimet tuaja dhe konsultimet e përbashkëta do të arrijmë në një unifikim të sistemit arsimor-ushtarak midis dy vendeve tona, si edhe do të jemi krah jush në arritjen e standardeve në kuadër të synimit për integrim në NATO, vijoi gjeneral Cikaqi".

Komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi dhe ekipi që e shoqëronte, nëpërmjet një paraqitje të shkurtër të mbajtur nga atasheu ushtarak shqiptar i akredituar në Kosovë, kolonel Fiqiri Hoxha u njoh me historikun e bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë në fushën e mbrojtjes, me draft marrëveshjen për unifikimin e arsimimit e trajnimit ushtarak, si dhe me asistencën për integrimin në NATO të FSK-së, për të cilat u bënë diskutime përkatëse.

Mbi titulli: Manifestimi Qendror i "Epopesë së UÇK-së"u mbajt në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë

E kaluara e lavdishme frymëzim për të ardhmen

Me parakalimin e kuadrateve të FSK-së, në kazermën "Adem Jashari" të FSK-së, filloi manifestimi "Epopeja e UÇK-së" më 5, 6 dhe 7 mars, në nderim të komandanti legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit.

Me rastin e 16-vjetorit të rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari, nën përkujdesjen e kryeministrit të



Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, më 5 Mars 2014, në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt manifestimi qendror "Epopeja e UÇK-së" në të cilën manifestim morën pjesë: presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga, kryetari i Parlamentit të Kosovës Jakup Krasniqi, kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ambasadorë, përfaqësuesi i familjes Jashari, Bekim Jashari, ministra, zëvendës ministra, deputet, veteranë, invalidë dhe përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, drejtues të institucioneve shtetërore, qytetarë dhe mxënës të shkollave të Kosovës.

Fillimisht, presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati iu bënë revistë kuadrateve të FSK-së, të rreshtuara në kazermën "Adem Jashari". Manifestimi filloi me intonimin e himnit kombëtar dhe atë shtetëror të Republikës së Kosovës, ekzekutuar nga Orkestra frymore e FSK-së. Pas revistës, presidentja Atifete Jahjaga, kryetari i Parlamentit Jakup Krasniqi, kryeministri Hashim Thaçi dhe përfaqësues të Shoqatave të Dala nga Lufta vendosen kurora me lule pranë Obeliskut të Dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri.

Në manifestimin "Epopeja e UÇK-së", me nga një fjalë tematike u paraqitën, presidentja Jahjaga, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, Hashim Thaçi dhe Bashkim Jashari..

Me këtë rast, presidentja Jahjaga, tha se: "Çdo vit në këtë ditë, ne përkujtojmë dhe nderojmë sakrificën sublime të gjithë atyre që dhanë jetën për shtetin, për lirinë dhe për paqen. Gjithashtu, ne kujtojmë edhe sakrificën e të gjitha brezave që me idealin e tyre i dhanë jetën dhe shpirtin Pavarësisë sonë. Rruga deri këtu ishte e vështirë dhe aspak më e lehtë nuk do të jetë puna dhe angazhimi që po na pret në forcimin e vlerave demokratike deri në arritjen e qël-



limeve tona; anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO".

Më pas, presidentja Jahjaga kërkoi nga të gjithë angazhimin maksimal për ndërtimin e shtetit. Po ndajmë një fragment nga fjalimi i saj."Sot më shumë se kurrë na duhet një dashuri më e madhe për atdheun, një respekt dhe solidaritet për njëritjetrin, një bashkim i forcave tona dhe tejkalim i dallimeve të thella politike për qëllimet madhore të Kosovës. Na duhet punë dhe sakrificë më e madhe për t'iu bërë ballë sfidave në përmbushjen e synimeve tona. Synimi ynë është që vendit tonë duhet t'i krijojmë një të ardhme të qëndrueshme, një Kosovë e cila do të mbetet rrëfim suksesi i përbashkët i yni dhe i bashkësisë ndërkombëtare dhe një vlerë e shtuar për aleatët tanë strategjikë".

Ndërsa, kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi tha se me luftën e drejtë, vendosmërinë heroike dhe mbështetjen ndërkombëtare, Kosova e realizoi ëndrrën më të lartë të saj - Lirinë. Më tej, kryeministri shtoi: "Në themelet e kësaj ëndrre qëndron mundi dhe djersa e qytetarëve tanë, e mbi të gjitha gjaku dhe sakrifica e dëshmorëve të lirisë, ku me respekt përjetë përulemi para sakrificës së tyre ".

Kryeministri Thaçi, tha gjithashtu: "Dëshmi e përkushtimit tonë institucional për perspektiven tonë euroatlantike jeni vetë ju, të nderuar pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Kosovës, që me profesionalizmin tuaj po bëni që të gjithë ne të jemi krenarë. Forcat e Armatosura të Kosovës do të jenë profesionale dhe shumetnike, do të vazhdojmë të zhvillohemi sipas standardeve dhe natyrisht në të ardhmen e afërt do të jemi edhe pjesë e NATO-s".

Gjithashtu, kryeministri Thaçi, tha se në prag të gjashtëmbëdhjetë vjetorit të Epopesë së UÇK-së, është marrë vendimi për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës dhe urimet e para ua drejtoi ushtarëve të Forcave të Armatosura të Kosovës.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në manifestimin e 16- vjetorit të legjendës kombëtare, tha: "Ne vijmë me avancime të institucionit tone", duke shtuar se FSK-ja po tregon në vazhdimësi, disiplinë, profesionalizëm, përkushtim dhe gatishmëri për avancim drejt përgjegjësive kombëtare e ndërkombëtare, duke ndihmuar vendin tonë në synimin e tij, anëtarësimin në familjen e madhe të sigurisë globale.

Më tej gjeneral Kastrati tha: "Sot, në këtë përvjetor legjendash, në nderim të kësaj ngjarje të madhe emblematike janë rreshtuar para nesh kuadratet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kuadratet që tregojnë përkushtimin e Kosovës që ka bërë për të ndërtuar forcat e veta ushtarake. Forcë të cilën e kishin ideuar dhe vulosur me sakrificën dhe heroizmin e tyre komandanti legjendar Adem Jashari dhe bashkëluftëtarët e tij, përfundoi komandanti i FSK-së, gjeneral Kadri Kastrati.

Në emër të familjes Jashari manifestimin e përshëndeti Bekim Jashari, djali i Hamëz Jasharit i cili pasi që shprehi lavdi për të gjithë dëshmorët e rënë për liri, uroi edhe krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Në fund të këtij manifestimi parakaluan kuadratet e njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës me intonimin e Marshit ushtarak të ekzekutuar nga Orkestra frymore e FSK-së.

Fjala e plotë e komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratit, me rastin e 5 Marsit, "Ditët e Rezistencës"

E nderuara presidente Jahjaga, i nderuar kryeministër Thaçi, e nderuara familje e komandantit legjendar Adem Jashari, baca Adem Demaçi, zëvendëskryeministra, ministra, ministër Çeku, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues të institucioneve shoqërore, politike e ushtarake, familje të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të luftës për liri, të nderuar të pranishëm,

Zonja dhe zotërinj,

Me rastin e shënimit të kësaj ngjarje sublime për vendin tonë, "Epopenë e UÇK-së", ju përcjell urimet dhe përshëndetjet e të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së.

Sot, në përvjetorin e 16-të të Epopesë së lavdishme të UÇK-së, ne pjesëtarët e FSK-së, si e gjithë Kosova dhe tërë populli shqiptar, kujtojmë heroizmin dhe madhështinë legjendare të Jasharajve, kujtojmë kullën, ku prehet nderi shqiptar, kullë e cila kishte brenda zemrën e madhe të komandantit legjendar të luftës për liri, Adem Jasharin, plakun fisnik, Shaban Jasharin, trimin e paepur Hamzë Jasharin, nipat dhe mbesat e Shotë e Azem Galicës.

Ne sot kujtojmë me krenari vendimin legjendar të Jasharajve, "Nëse duhet vdekur dikush, më mirë të gjithë ne, sesa Atdheu", kishin thënë të gjithë Jasharajt, në kullë. Ne sot kujtojmë jehonën e pushkëve dhe këngën e trimave që po shkruanin simfoninë e qëndresës së pamposhtshme. Jehonë e cila po prekte rrënjët dhe majën e historisë së luftës për liri. Kujtojmë kullën e Jasharajve që u bë muranë e lirisë.

Të nderuar të pranishëm, në këtë 16- vjetor të legjendës kombëtare, ne vijmë me avancime të institucionit tonë, Institucion që po tregon në vazhdimësi, disiplinë, profesionalizëm, përkushtim dhe gatishmëri për avancim drejt përgjegjësive kombëtare e ndërkombëtare, duke ndihmuar vendin tonë në synimin e tij, anëtarësimin në familjen e madhe të sigurisë globale.

Sot në këtë përvjetor legjendar, në nderim të kësaj ngjarje të madhe emblematike janë rreshtuar para nesh kuadratet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kuadrate që tregojnë përkushtimin e Kosovës, që ka bërë për të ndërtuar forcat e veta ushtarake. Forcë të cilën e kishin ideuar dhe vulosur me sakrificën dhe heroizmin e tyre komandanti legjendar Adem Jashari dhe bashkëluftëtarët e tij.

Ne sot kujtojmë përpjekjet dhe sakrificën shumëvjeçare për liri dhe pavarësi të vendit tonë, kujtojmë ngritjen dhe ndërgjegjësimin e vetëdijes kombëtare për organizim dhe mobilizim në luftën tonë të shenjët, kujtojmë shumë luftime, beteja, rënie e heroizma të luftëtarëve të UÇK-së, kujtojmë organizimin, mobilizimin dhe luftën tonë të drejt liridashëse që u përkrah dhe mbështet nga forcat përparimtare ndërkombëtare të udhëhequra nga SHBA-të dhe aleanca më e madhe ushtarake NATO.

Të nderuar të pranishëm, FSK-ja, gjithherë duke pasur nismë këtë kujtim, është arsimuar, profesionalizuar, zhvilluar, modernizuar dhe çdo ditë ka dëshmuar se është një partnere e denjë dhe mund të punojë krah për krah me NATO-n në çdo mision.

Sot rezultat i një avancimi të gjithëmbarshëm dhe gatishmërie profesionale, FSK po ecë drejt marrjes së detyrave dhe përgjegjësive kombëtare; FSK po ecë drejt avancimit në Forca të Armatosura të Kosovës.

Bashkëpunimi që kemi ndërtuar me NATO-n është arritje e madhe e cila vlerësohet nga të gjithë, andaj ne sot u jemi mirënjohës miqve tanë ndërkombëtarë për atë që kanë bërë dje në luftë dhe për atë që bëjnë sot në liri.

Dhe në fund, të nderuar të pranishëm!

Jemi me fat që dje i takuam epokës më të ndritur të kombit tonë, epokës së UÇK-së, epokës së









komandantit legjendar Adem Jashari . Ne sot jemi me fat që po ndërtojmë vendin tonë drejt së ardhmes së ndritur në bashkëpunim me miqtë tanë ndërkombëtarë. Andaj ne sot duhet të shfrytëzojmë këtë privilegj për të punuar për një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Në këtë rrugëtim, frymëzimi ynë, gjithmonë ishte dhe do të jetë heroizmi legjendar i Jasharajve, luftëtarëve të UÇK-së dhe dëshmorëve të rënë.

Lavdi heroizmit legjendar të familjes Jashari, lavdi heroizmit të komandantit legjendar Adem Jashari, lavdi dëshmorëve të UÇK-së dhe martirëve të rënë.

Ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati bën homazhe në Prekaz

Në përvjetorin e 16-të të rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari, më 6 mars, ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, së bashku me stafin e lartë të MFSK-FSK-së, bënë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, së bashku me një delegacion të Qeverisë së Kosovës, të prirë nga kryeministri i Kosovës, z. Thaçi, presidentja e Kosovës, znj. Jahjaga dhe ministrat e kabinetit qeveritar, bënë homazhe dhe vendosen kurora lulesh në nderim të komandantit Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit.



Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i printe delegacionit të FSK-së ku merrnin pjesë: sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, zëvendës komandanti i KFT-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneralët Enver Cikaqi, Ilaz Dërguti, si dhe oficerë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së.

Me këtë rast, në fjalën e tij komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, tha: "Jemi sot këtu, së bashku me udhëheqësit e FSK-së, për ta nderuar veprën heroike të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit.

Kjo është një datë e veçantë për FSK-në, sepse këtu, sa here vijmë, marrim energji të reja dhe gjejmë motive për punë dhe suksese të reja. Ky 16-vjetor, për ne, shënon edhe një arritje të jashtëzakonshme, formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës".

Delegacioni i FSK-së, më pastaj qëndroi për vizitë në Kullën e Jasharajve, ku u pritë nga Murat Jashari, nipi i komandantit Adem Jashari.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati ka pritur në vizitë lamtumirës shefin e Shtabit të NLAT-it, kolonelin Vincenzo Matina

Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati së bashku me zëvendës komandantin e KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrollin, pritën në një takim lamtumirës, shefin e Shtabit të NLAT (KFOR) kolonel Vincenzo Matina, me rastin e përfundimit të misionit të tij, në FSK-së. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Kadri Kastrati e ka falënderuar ekipin e NLAT-it, si dhe kolonelin Vincenzo Matina për angazhimin e tij, në drejtim të ngritjes profesionale të FSK-së. Gjeneral Kastrati i ka dhënë "Mirënjohje" kolonelit Matina, në shenjë të angazhimit të tij, për FSK-në.
Në fund, shefi i Shtabit të NLAT-it, koloneli Vincenzo Matina, ka falënderuar Gjeneral Kastratin dhe Gjeneral Hazrollin, për bashkëpunimin e deritashëm në mes ekipit të NLAT-it dhe FSK-së.



MFSK-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Gruas

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas , 8 Marsit, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, organizuan në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), një takim me të gjitha gratë që shërbejnë në MFSK dhe FSK, ushtarake dhe shërbyese civile.
Në këtë takim morën pjesë ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFOR-it, gjenerali Salvatore Farina, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade gëzim Hazrolli, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, përfaqësuesja e organizatës joqeveritare "Rrjeti i grave" Igballe Rugova, si edhe deputetja Ganimete Musliu, anëtare e Komisionit për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.
I pari, 8 Marsin ua uroi grave ministri i MFSK-së, Agim Çeku, i cili me këtë rast tha: "Femrat që punojnë në Ministri dhe Forcë janë shumë aktive, të devotshme dhe vazhdimisht kanë dhënë rezultate në punë dhe shërbim. Ministria dhe Forca kanë bërë shumë punë që të rekrutojnë sa më shumë femra dhe se ky mund është duke u shpërblyer. Ne jemi krenar që si vend po aspirojmë integrimin euroatlantik dhe i tërë zhvillimi i institucionit tonë po bëhet në përputhje me këto standarde"përfundoi ministri Çeku .
Ndërsa komandanti i FSK-së, gjen-



erallejtënant Kadri Kastrati, në fjalën e tij më këtë rast u shpreh: "Ndjehem tejet krenar që jam komandant i Forcës, në të cilën shërbejnë me sukses bashkëkrisht meshkuj dhe femra pa dallim". Më tej gjeneral Kastrati tha se të gjitha raportet që Ai pranon si komandant tregojnë për një performancë të shkëlqyer të ushtarakeve të Forcës gjatë shërbimit. Në fund gjeneral Kastrati i siguroi ushtaraket se përherë do ta kenë vlerësimin e drejtë për punën që bëjnë në njësi si dhe do të përkujdeset për ngritjen profesionale dhe avancimin e tyre .
Gjeneral major Salvatore Farina, komandanti i KFOR-it në Kosovë, foli për rolin e femrave në Forcat e Armatosura si dhe u shpreh se ndjehet i entuziazmuar me zhvillimet që i ka bërë FSK-ja duke arritur të rekrutojë dhe të trajtojë me dinjitet një numër të mirë të femrave duke e ditur që edhe në vendet e NATO-s, rekrutimi ka filluar jo shumë vite më parë, duke përmendur shembullin e Italisë, e cila ka filluar angazhimin e femrave në ushtri që nga vitit 2000. Ai me këtë rast përgëzoi ministrin Çeku dhe gjeneral Kastratin për kujdesin e treguar ndaj çështjes gjinore.
Në fund, me një fjalë tematike, takimin festiv e përmbylli Remzie Zeqiraj, oficere për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e FSK-së. Major Zeqiraj, pasi përshëndeti gratë dhe të pranishmit të tjerë, tha se për nderë 8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës kanë organizuar këtë takim me qëllim që nëpërmjet këtij aktiviteti simbolik, ta shënojmë këtë ditë dhe, gjithashtu, të tregojmë me këtë akt se femrat në MFSK dhe FSK janë të vlerësuara denjësisht për kontributin që japin çdo ditë.
Major Zeqiraj, më pastaj, shtoi se: "Ne femrat -vajzat dhe gratë me shërbim në Ministri dhe Forcë, tani më, jemi në numër të konsiderueshëm, si në uniformë po ashtu edhe si shërbyese civile, ku shërbejnë me sukses në të gjitha njësitë, manovruese dhe ato të specializuara. E them me plot bindje se femrat ushtare, nënoficerë dhe oficere në vazhdimësi kanë tregua motivim, përkushtim, profesionalizëm dhe disiplinë duke qenë kështu të devotshme dhe të denja për punën që bëjnë.
Ajo shtoi se "trëndafilat e kuq", që i morëm nga ministri, simbolikisht ua dedikojmë të gjitha femrave që ranë për liri, pikërisht në këtë ditë para 16 vjetëve në Prekaz, në Likoshan, në Meje, Celinë e kudo në Kosovë..
Femrat që shërbejnë në institucionin tonë, shtoi major Zeqiraj, kanë dhënë kontribut edhe në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe tani në MFSK, ku mund të them lirisht se vullneti dhe angazhimi konkret i femrave ka qenë motivim dhe shtytje edhe për gjininë mashkullore. Ne me shembullin tonë, tha Ajo, kemi dëshmuar se mundemi, duam dhe duhet të jemi faktor zhvillimi i institucionit, faktor i profesionalizimit dhe faktor që do të ndikojë në afirmimin e vlerave tona të përbashkëta si institucion dhe si shtet.
Në fund, major Zeqiraj, tha se "edhe përkundër që jemi institucion i ri, vetëm me 5 vite të plota ngritje, zhvillim dhe profesionalizim, para nesh tani është edhe një mision i ri, unë shpresoj, ashtu si deri më tani, të gjithë bashkërisht ta zhvillojmë ushtrinë dhe vendin tonë, duke mos e harruar asnjëherë misionin shtetëror e kombëtar.
Duke ua uruar 8 Marsin, major Zeqiraj premtoi për angazhimin e të gjitha grave; "Ne nuk do të ndalemi së punuari jo vetëm për të sotmen por edhe për të ardhmen e ndritur dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e atdheut tonë".
Për ta bërë këtë ditë edhe më të veçantë, në tubim ishin të pranishme edhe shumë përfaqësuese të organizatave joqeveritare të grave në Kosovë, ku znj Igballe Rugova si përfaqësuese e OJQ-së foli për historikun e Ditës Ndërkombëtare të Gruas.
Pas këtij aktiviteti një delegacion i femrave ushtarake dhe disa shërbyese civile të Ministrisë dhe Forcës vazhduan rrugën për në Prekaz për t'ju bërë nderime dëshmorëve të kombit, tek Kompleksi Memorial "Adem Jashari". Delegacioni i ushtarakeve vuri kurora lulesh tek vendi ku pushon komandanti legjendar si dhe vizituan familjen Jasharaj, ku u priten nga Shqipe Jashari, Besarta Jashari, motrat e heronjve dhe bijat e tyre, nipat e mbesat.

Gjeneralbrigade Imri Ilazi përfundon karrierën ushtarake në FSK

Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, u organizua ceremoni përcjellëse për gjeneral brigade Imri Ilazin, të cilit që nga 27 shkurti i është miratuar kërkesa për demobilizim nga FSK-ja nga ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati.
Në ceremoninë e organizua me këtë rast morën pjesë: ministri Agim Çeku, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministrat Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi, sekretari i përgjithshëm i FSK-së, Shkëlzen Sylaj, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral Ilaz Dërguti, oficerë të lartë të Ministrisë dhe të FSK-së, si dhe bashkëpunëtorë dhe miq të gjen-





eral Ilazit.
Në fjalën përshëndetëse të mbajtur me këtë rast, ministri i FSK-së Agim Çeku ndër të tjera ka vlerësuar lartë angazhimin, punën dhe profesionalizimin e gjeneral Imri ilazit. Ministri Çeku tha: " Gjeneral Ilazi gjithmonë është angazhuar maksimalisht dhe profesionalisht për të dhënë më të mirën në ngritjen e FSK-së, dhe në shërbim të interesit të Kosovës. Gjeneral Ilazi, gjithkund ku ka punuar, si në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe në Forcat e Sigurisë së Kosovës, është dalluar për arritjen e rezultateve të shkëlqyeshme. Gjeneral Ilazi, kudo, ku ka punuar, ka punuar me përkushtim. Edhe në udhëheqjen e tij, drejtor i Departamentit të Operativës dhe Trajnimeve në Ministrinë e FSK-së, është dalluar me punën e palodhshme, me çka, mirënjohja më e madhe e tij, janë sukseset në të gjitha fushat e kësaj drejtorie. Gjatë punës në FSK dhe MFSK, Ai u dallua në përgatitjen e kuadrove të reja dhe profesionale, që i ka vënë në shërbim të FSK-së dhe në interes të përgjithshëm të Kosovës", tha në fund Ministri Agim Çeku. Imri Ilazi pas luftës, fillimisht, ka punuar në Akademinë e Mbrojtjes së TMK-së si zëvendës komandant i saj në Prishtinë, pastaj ka kryer detyrën e zëvendës komandantit dhe komandantit në Zonën e Gjashtë Mbrojtëse të TMK-së në Gjilan, i cili edhe këtu u dallua me përkushtimin e madh në realizimin e të gjitha detyrave të pranuar nga ai.
Në fund, ministri Çeku dhe komandanti Kastrati për ngritjen dhe zhvillimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjeneral Ilazin e dekoruan me Mirënjohje.

Kontraadmirali Odd Werin, shefi i delegacionit të Suedisë në NATO, vizitoi ministrinë për FSK

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 25 mars pritën në takim shefin e delegacionit të Suedisë në NATO, kundëradmiralin Odd Werin me bashkëpunëtorë.
Ministri Çeku falënderoi admiralin Werin për bashkëpunimin e shkëlqyer që MFSK-ja ka me shtetin e Suedisë, për shërbimin e kontingjentit të Forcave të Armatosura të Suedisë në kuadër të KFOR-it në Kosovë, për mbështetjen e pakursyer të këshilltarëve suedez në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s (NAT) për ministrinë e FSK-së, pastaj në fushën e bashkëpunimit ushtarako-civil, në fushën e drejtave të njeriut, në fushën humanitare (deminim) dhe në fusha tjera. Gjithashtu, ministri Çeku e njoftoj kundëradmiralin Werin mbi zhvillimin e FSK-së, ndërtimin e raporteve dypalëshe me shumë vende të NATO-s dhe vende të tjera, pjesëmarrjen në ushtrime të përbashkëta rajonale, për respektin që gëzon FSK-ja tek popullata vendore, për sfidat dhe perspektiven e saj, si dhe mbi procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë në Kosovë. Ministri Çeku u shpreh se me rastin e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë, ne kemi qenë mjaft transparent si për opinionin e brendshëm ashtu edhe për atë të jashtëm e sidomos për faktorët vendorë e ndërkombëtarë.
Nga ana e tij, kundëradmirali Odd Werin u shpreh jashtëzakonisht falënderues për transparencën e procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë në Kosovë, për aktivitetet në të mirë të popullatës së vendit në përgjithësi si dhe e përgëzoi për të arriturat e deritanishme të Ministrisë dhe FSK-së.
Një prezantim të hollësishëm të procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë e paraqiti këshilltarja politike e ministrit, Besa Kabashi-Ramaj, e cila e shtjelloj këtë proces që nga fillimi e deri tek miratimi i rekomandimeve në Qeveri.
Delegacioni i Suedisë dhe në veçanti admirali Werin shfaqën interesim për procesin në tërësi, për fazat e planifikuara të zhvillimit, fondet dhe çështje tjera të lidhura me të ardhmen.
Kjo ishte vizita e parë e admiralit Odd Werin në MFSK. Ai ishte i shoqëruar nga ambasadori i Suedisë në Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës, Mats Staffansson,



Henrik Nilsson, i ngarkuar me punë pranë Ambasadës së Suedisë në Kosovë, si dhe nga ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes të Suedisë dhe Forcave të Armatosura të Suedisë.
Ndërsa nga pala jonë në takim me delegacionin suedez, përveç ministrit Çeku dhe komandantit Kastratit morën pjesë edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Faruk Geci, këshilltarja politike e ministrit, Besa Kabashi Ramaj, si dhe shefi i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Sinan Geci.

Intervistë me Roland Reshitaj pjesëtar i Kompanisë së Deminimit të FSK-së

Demineri që ka pastruar shumë fusha të minuara dhe ka shkatërruar me qindra mina dhe mjete të tjera vdekjeprurëse

Roland Reshitaj në vitin 2009 inkuadrohet në Kompaninë e Deminimit të FSK-së, si ushtar i cili me sukses i ka kryer të gjitha nivelet e trajnimeve profesionale për çminimin e fushave të minuara dhe shkatërrimin e mjeteve të pashpërthyera. Ai e ka fituar gradën e instruktorit për ligjërimin e mjeteve të rrezikshme, si mina dhe mjete tjera të pashpërthyera.
Gjatë një vizite që i bëmë Kompanisë së Deminimit u bindem me angazhimin dhe me punën profesionale të pjesëtarëve të kësaj kompanie, të cilët gjatë sezonit të verës, kanë arrit të pastrojnë mijëra metra katror të fushave të minuara, si dhe kanë shkatërruar qindra mjete të pashpërthyera, të rrezikshme për qytetarët e Kosovës. Nga këto mjete kanë humbur jetën mbi 400 qytetarë të pafajshëm dhe shumë të tjerë kanë mbetur me pasoja për tërë jetën. Tani pjesëtarët e kësaj kompanie janë angazhuar për vetëdijesimin e nxënësve nëpër shumë shkolla, për rrezikun që sjellin minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera.
Komandanti i Kompanisë, kapiten Sejdi Krasniqi, me të kuptuar qëllimin e vizitës sonë, na sugjeroi që të bisedojmë me ushtarin e dalluar Roland Reshitaj. "Rolandi është shumë modest, të gjitha të arriturat e kompanisë ia dedikon shokëve të tij. Ai është nga Komuna e Suharekës, dhe në FSK ka filluar punën si ushtar në vitin 2009, në Kompaninë e Deminimit në Prizren" tha kapiteni i tij.
Roland Reshitaj ka përfunduar me sukses trajnimin për BAC, DEMINIM dhe EOD, niveli 1 dhe 2, ndërsa gjatë kryerjes së trajnimeve ishte shpallur kadeti më i mirë i gjeneratës së tij. Ai ka arrit që me sukses t'i kryej trajnimet profesionale, ku e merr titullin e instruktorit për ligjërim për vetëdijesimin nga mjetet e pashpërthyera, gjithashtu, Ai, pa shkëputje nga puna i kryen



studimet në Universitetin AAB në Prishtinë.
Pas përfundimit të trajnimit, specialisti profesional, Rolandi, u bashkohet njësive të Kompanisë së Deminimit që operojnë nëpër terrene ku rreziku nga këto mjete është ende i pranishëm.
"Fillimisht si çdo i ri punën e deminierit e kam parë sa të rrezikshme po aq edhe humane, kjo ka qenë edhe njëra nga arsyet që përkushtimi im ndaj kësaj pune të jetë maksimal.Gjatë punës sime si deminier kam pas fatin të punojë në shumë vende nëpër Kosovë, ku po veçoj, pos tjerash, pastrimin nga mjetet e rrezikshme në lokacionin ku tash ndodhet autostrada që lidh Kosovën me Shqipërinë, pra rrugën afër brezit kufitar. Gjithashtu jam angazhuar në pastrimin nga mjetet e rrezikshme në fshatin Milaj- Prizren, në zonën rreth fshatit Belincë-Shtime, në zonën afër fshatit Luzhnicë-Suharekë, pastaj në pastrimin e shtratit të lumit Drin-Vërmicë, në pastrimin e sipërfaqeve të malit Koretnik, si dhe në disa vende të tjera, varësisht se ku më është caktuar detyra.
Puna e një deminieri klasifikohet ndër punët më të rrezikshme në botë, për arsye se dihet një deminier merret me hulumtimin, identifikimin dhe asgjësimin e mjeteve eksplozive të pashpërthyera .
Ne çdo herë jemi të ekspozuar ndaj rrezikut, por motivi kryesor që na mban lart moralin është largimi apo shkatërrimi i çdo mjeti të pashpërthyer, i gjetur në fushë të rrezikshme, sepse një mjet i rrezikshëm është i barabartë me më shumë se një jetë njeriu, vazhdon rrëfimin e tij ushtar Reshitaj.
"Nuk ka ndjenjë më të mirë se kur një fushë të rrezikshme nga mjetet plasëse, ne, e pastrojmë dhe aty rikthehet loja e fëmijëve. Ju them me plot bindje se as shkrimtari më i mirë nuk do të kishte fjalë që ta përshkruante at ndjenjë që na kaplon pas kryerjes me sukses të çminimit.
Pas çdo dite kur unë e përfundoj punën, së pari e falënderoj Zotin për çdo gjë ka shkuar mirë, falënderoj kolegët e mi që për mua janë familja ime e dytë. Mund të them me bindje se jam me fat që në Kompaninë e Deminimit kam shumë kolegë me përvojë të madhe në këtë fushë, pra që nga koha e TMK-së, të cilët më kanë ndihmuar shumë në aftësimin tim profesional, duke pasur parasysh që puna jonë përveç edukimit teorik ka të bëjë shumë edhe me përvojën në praktikë, sepse jo çdo herë mjetet e rrezikshme gjenden ashtu siç ne i kemi mësuar, pra çdo ditë mund të përballemi me situata të paimagjinueshme.
Profesionalizmi i gjithë personelit të Kompanisë së Deminimit, është edhe një fakt i rëndësishëm për ne, sepse falë këtij profesionalizimi, prej vitit 2000 e deri më tani, kemi pastruar afër 100 000 000 m2 dhe kemi asgjësuar më shumë se 83 000 mjete eksplozive plasëse dhe fatmirësisht nuk ka pësuar asnjë deminier, qoftë edhe me ndonjë lëndim të lehtë.
" Fillimisht kam pasur emocione të përziera, gjatë demolimit-shkatërrimit të bombës së parë, që ka qenë një kasetë bombë BLU 97. E para; ishte një moment i rëndësishme për mua, e dyta ishte dëshira ime ta kaloj me sukses këtë sfidë, për të cilën edhe isha trajnuar, dhe dëshira më e madhe e imja ishte t'i eliminoja të gjitha bombat e mbetura nga lufta e fundit në Kosovë, të cilat kishin vrarë dhe plagosur qindra qytetarë, në mesin e tyre; fëmijë, gra dhe pleq. Në fillim e kisha pak më të vështirë, tani kjo është shumë e lehtë, jo vetëm për mua por për tërë ekipin, sepse tani jemi të përgatitur profesionalisht. Ai edhe tani kujton momentin e çminimit të parë "Kur mbërrita te numërimi: 3,2,1, ZJARR , shtypa butonin e eksploderit dhe menjëherë u dëgjua një shpërthim i madh..., Një ndjenjë lehtësie ma përshkroi trupin, ishte fillimi i një karriere e cila besoj që do të më përcjellë gjatë gjithë jetës, e cila dita- ditës më bënë shumë krenar", na tregoi me krenari ushtari Reshitaj.
Gjatë periudhës të sezonit-dimëror, kur njësitet i ndërpresin operacionet për shkaqe të kushteve atmosferike, ne së bashku me instruktorët e tjerë të Kompanisë së Deminimit vazhdojmë me ligjërata nëpër shkolla fillore dhe të mesme, me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve për rrezikun që sjellin minat dhe mjetet tjera plasëse, si dhe për mënyrën e sjelljes së tyre në praktikë.
Kryesisht, sipas këtij plani, prioritet u japim atyre shkollave të cilat ndodhen në zonat ku kanë mbetur ende mjete eksplozive të pashpërthyera, por edhe në shkollat e tjera anembanë Kosovës.
Gjatë orëve mësimore, që ne i mbajmë me nxënës, ne mundohemi që atyre t'u mësojmë t'i identifikojnë (njohin) mjetet e rrezikshme, t'ua mësojmë procedurat e veprimit, që në asnjë mënyrë mos t' i prekin dhe të veprojnë sipas procedurave që i mësojnë dhe që duhet t'i ndjekin, në rast se hasin në ndonjë mjet të pashpërthyer.
Gjatë ligjërimit aplikojmë edhe metodën e bashkëbisedimit me nxënës. Nga pyetjet që ata parashtrojnë, shohim se interesimi i tyre që të pajisen me njohuri është mjaft i madh.
Ushtar Reshitaj ka një mesazh për qytetarët e Kosovës: "Ne jemi çdo herë në shërbimin tuaj, në mënyrë që t'ju ofrojmë një jetë më të sigurt, andaj ju bëjë thirrje që çdo mjet të dyshimtë që hasin, MOS E PREKIN, por menjëherë lajmëroni Policinë e Kosovës, FSK-në apo KFOR-in. Unë uroj që kurrë askujt mos t'i ndodhë ndonjë e keqe nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera"

Aktivitete trajnimi të FSK-së në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj

Certifikohen pjesëtarët e kursit "Procedura e Udhëheqjes së Trupave"

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve, pas përfundimit të kursit "Procedura e Udhëheqjes së Trupave" (PUT). Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, përfaqësuesi i Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës i NATO-s, (NLAT) kolonel Dean Kranjcec, si dhe oficerë tjerë të KDS-së dhe ekipit të NLAT-it .

Me këtë rast, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, u shpreh se ndjehet i lumtur që ky kurs ka dhënë rezultate të larta dhe është cilësuar mjaft frytdhënës, si nga ana e pjesëmarrësve ashtu edhe nga ana e instruktorëve. Për këtë flasin më së miri edhe rezultatet e arritura në testin final.

Gjeneral Cikaqi i porositi kadetët, që njohuritë e fituara këtu t'i bartin me sukses tek njësitë e juaja, sepse ky kurs e arrin efektin e tij vetëm atëherë kur pjesëtarët e njësive tuaja t'i mësojnë këto procedura dhe t'i standardizojnë në nivel të FSK-së.

Ndërsa, komandanti i Qendrës së Stërvitjes Kolektive(QSK), major Naim Sylejmani, foli për rolin dhe rëndësinë e kursit, nevojën për të mësuar se si duhet udhëhequr me trupat, si dhe për angazhimin e pjesëtarëve dhe të instruktorëve të cilët me angazhimin e tyre maksimal bënë që të arrihen këto rezultate të larta.

Kjo është gjenerata e parë për vitin 2014 që po e realizon Qendra e Stërvitjes Kolektive, në kuadër të planit kalendarik të trajnimeve. Në këtë trajnim morën pjesë 16 pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së. Kursi është realizuar nga data 18 shkurt deri më 11 mars 2014. Kursin e kanë ndjekur pjesëtarët e nivelit komandant skuadre deri tek niveli komandant kompanie, me grada kapter deri te grada kapiten.

Temat kryesore të cilat janë mësuar gjatë trajnimit janë: lidershipi, taktikat, trillet e betejave, procedurat e udhëheqjes së trupave, simbolet dhe grafiket taktike, planet dhe urdhrat, ndërtimi i maketit, sistemi i informacionit gjeografik (GIS), ushtrimi në harta, etj.

Vlen të cekët se trajnimi është realizuar në formën e kombinuar teoripraktikë, ku kadetët patën rastin që për secilën temë njohuritë e marra në teori t'i demonstrojnë edhe në praktike, në maketin e punuar nga QSK-ja, si dhe duke praktikuar ushtrime në harta.

Në fund për të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit u ndanë certifikata



dhe mirënjohje nga komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi, zëvendëskomandanti, kolonel Spahiu dhe përfaqësuesi i NLAT-it, koloneli Dean Kranjcec.

Certifikohen edhe pjesëtarët e kursit "Reaguesit e Parë në Fushëbetejë"

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj u organizua ceremonia e certifikimit të kadetëve, pas përfundimit të kursit bazik "Reaguesit e Parë në Fushëbetejë", Kursi zgjati dy javë dhe u ndoq nga 9 kadetë të FSK-së.

Ky kurs kishte një rëndësi të veçantë për pjesëtarët e FSK-së të cilët morën njohuri bazike, si në aspektin teorik po ashtu edhe atë praktik, për reagimin e parë në fushëbetejë, tha komandanti i QSS-së, major Feriz Trezhnjeva.

Ndërsa, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, në fjalën e saj ndër të tjera tha: "Angazhimi i kadetëve gjatë trajnimit ka qenë në nivelin më të lartë profesional, kjo më gëzon, dhe ndjehem krenare për punën dhe angazhimin tuaj që keni treguar gjatë këtij trajnimi. Unë i



përcolla me vëmendje kadetët, gjatë demonstrimit të pjesës praktike, dhe pashë se kursi ishte shumë sfidues, mirëpo angazhimi i kadetëve dhe instruktorëve kanë bërë që kursi " Reaguesit e Parë në Fushëbetejë" të jetë më i përballueshëm dhe më i lehtë në përballimin e barrierave që dalin përpara".

Gjithashtu edhe përfaqësuesi i Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës i NATO-s (NLAT) major Giorgio Ecclesie, tha:" Ndjehem mirë që jam para jush në emër të NLAT-it, ku kam kënaqësinë të ndaj bashkë me ju krenarinë dhe bashkëpunimin. Ky kurs që ju po përfundoni sot, është një nga trajnimet i cili gjatë periudhave sa kam marrë pjesë nëpër misione jashtë vendit, sidomos në Afganistan, na është nevojitur më së shumti. Reaguesit e parë janë ata të cilët u japin ndihmë pjesëtarëve në fushëbetejë të parët, dhe është një punë e cila donë përkushtim për të arritur rezultate, mirëpo unë kam parë, se ju e keni edhe përkushtimin, edhe vullnetin dhe për këtë më së miri flasin rezultatet tuaja, për çka ju përgëzoj dhe ju uroj suksese".

Kursi"Reaguesit e parë në fushëbetejë", fillimisht, është realizuar nga instruktorët e Ushtrisë Amerikane, të cilët i kanë përgatitë instruktorët e FSK-së, ndërsa, tani këto trajnime po i kryejnë me sukses instruktorët e KDS-së, të cilët po e realizojnë kursin me temat e njëjta dhe po përgatisin pjesëtarët e FSK-së se si duhet reaguar në situata të tilla.

Në fund, Major Treshnjeva, kërkoi nga kadetët që njohuritë e fituara gjatë trajnimit t'i bartin nëpër njësitë e tyre, ndërsa kjo është edhe një mundësi e mirë që trajnimet po standardizohen në të gjitha njësitë e FSK-së. Disa nga temat kryesore të cilat janë ligjëruar gjatë këtij trajnimi janë: kryerja e kujdesit taktik luftarak, kontrollimi i gjakderdhjes, hapja dhe menaxhimi i kanaleve të frymëmarrjes, trajtimi i plagëve shpuese të kraharorit, inicimi i kartelës mjekësore të terrenit, kërkesa për evakuim mjekësor dhe zhvendosja taktike e viktimës, etj.

Vlen të ceket se trajnimi është realizuar në formë të kombinuar teori dhe praktikë, ku pjesëtarët patën rastin të demonstrojnë se si duhet reaguar në fushëbetejë dhe njohuritë e marra në teori t'i aplikojnë edhe në praktikë.

Në fund, kolonel Irfete Spahiu, major Giorgio Ecclesie dhe major Feriz Trezhnjeva, për pjesëmarrësit e kursit ndanë certifikata.

Kadetët e Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, realizojnë ushtrimin fushor të koduar "Marsi 2014"

Bazuar në planin kalendarik të trajnimeve njësitë e KDS-së janë duke realizuar trajnime të ndryshme në bazë të planit të punës. Kështu, njëra nga njësitë e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), Qendra e Studimeve Universitare (QSU), ka realizuar ushtrimin fushor të koduar "Marsi 2014".

Kadetët e QSU-së, gjatë mbajtjes së ushtrimit të fushor i vizitoj zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, e cila me këtë rast i përgëzoi kadetët për angazhimin e tyre dhe stafin e QSU-së, për një përgatitje të nivelit të lartë, ku ndër të tjera theksoi, se: "me një angazhim të tillë ju do të jeni të gatshëm që t'i realizoni detyrat të cilat dalin nga misioni i njësisë, ku ju, do të shërbeni, gjithashtu, ky përkushtim i juaji besoj se do të jetë edhe në të ardhmen si pikë referimi për zhvillimin e karrierës".




Ndërsa, komandanti i QSU-së, kapiten Avni Kiqina ka ndjek nga afër realizimin e ushtrimit fushor, ku bashkërisht me stafin e QSU-së, ka dhënë vlerësimin final për angazhimin e kadetëve, për të theksuar se përveç pjesës teorike të cilën kadetët janë duke e realizuar në hapësirën e QSU-së, po e kompletojmë edhe pjesën praktike e që ka qenë shumë e nevojshme për kadetët tanë".

Kadetët e QSU-së, pjesën teorike e realizuan në hapësirat e Kazermës "Skënderbeu" realizuar nga instruktorët e KDS-së, prej datës 14-16 mars 2014. Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë 6 pjesëtarë të stafit të QSU-së dhe 34 kadetë të cilët janë ndarë në dy grupe. Meqenëse të gjithë ishin kadetë në ushtrim, stafi i QSU-së, ka ndarë detyrat për kadetët në bazë të përvojës së gjeneratave, kjo për shkak se pjesëmarrës ishin kadetë që nga viti i parë e deri te viti i katërt. Ndërsa, stafi i QSU-së ka vëzhguar trajnimin nga afër dhe ka analizuar me kujdes punën e tyre dhe realizimin e Ushtrimit Fushor, pas të cilit është bërë edhe një analizë, ku janë dhënë rekomandime për përmirësimin e disa elementeve.

Vlen të ceket se kadetët gjatë periudhës 4 vjeçare realizojnë disa ushtrime fushore, mirëpo kadetët e vitit të parë janë ata që kanë nevojë më së shumti të familjarizohen me rolin dhe detyrat që duhet t'i kenë në terren si dhe me sfidat me të cilat duhet të ballafaqohen.

Vlerësimi final ishte se ky ushtrim ka qenë mjaft frytdhënës dhe ka ndihmuar kadetët që të shohin sfidat me të cilat mund të ballafaqohen gjatë karrierës së tyre ushtarake, dhe vendimet të cilat duhet t'i marrin.

fotolajm



FSK-ja ndërtoi urë afër Manastirit të Deçanit

Batalioni i Xhenios të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), ka përfunduar punimet e ndërtimit të urës- montazh, në Deçan,(afër Manastirit të Deçanit). Ky është projekti i dytë i këtij lloji, që FSK-ja po e realizon, për nevojat e Manastirit të Deçanit. FSK-ja, në realizimin e këtij projekti është angazhuar, me kërkesë të Manastirit të Deçanit. Batalioni i Xhenios punimet i ka filluar më 12 mars dhe i ka kryer më 19 mars 2014, ndërsa, financimin e ka bërë Ambasada e Gjermanisë, në Kosovë.

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 23 • Maj 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Çeku: Nisi rrugëtimi për anëtarësim në NATO



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Agim Çeku, e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm vendimin për pranimin e Kosovës si anëtare vëzhguese në Asamblenë e Përgjithshme të NATO-s. Ai ka thënë se me këtë veprim Kosova ka hyrë në shtëpinë e organizatës më të fuqishme ushtarake në botë.

Në një bisedë për "Epokën e re", ai ka bërë me dije se pranimi i kërkesës së Kosovës për t'u bërë anëtare vëzhguese në Asamblenë e NATO-s nuk është vetëm privilegj, por edhe përgjegjësi. "Ky është hap i parë dhe shumë i rëndësishëm për integrimin e Kosovës në këtë aleancë. Më e rëndësishmja është se me këtë hap Kosova ka hyrë në shtëpinë e NATO-s. Pra, tani përfundimisht Kosova është brenda strukturave të NATO-s. Statusi i vëzhguesit është procedurë e rregullt, kurse hapi tjetër është anëtarësimi i Kosovës në Asamblenë e NATO-s", ka thënë Çeku.

Me këtë vendim, ka deklaruar Çeku, Kosova është edhe një hap më tej drejt partneritetit për paqe me NATO-n.

"Ky është një zhvillim shumë pozitiv për Kosovën, është përfundimisht një hap shumë i madh drejt raporteve formale të partneritetit të NATO-s. Me këtë vendim Kosova tanimë ka hyrë në shtëpinë e NATO-s dhe është më afër partneritetit për paqe. Me krijimin e Forcave të Armatosura Kosova tanimë i plotëson kushtet e nevojshme për marrëdhënie partneriteti me NATO-n dhe më vonë edhe anëtarësim të plotë në NATO", është shprehur Çeku, duke shtuar se tani e tutje zëri i Kosovës do të dëgjohet brenda strukturave të NATO-s.

Sipas tij, nga mbledhja e ardhshme Kosova do të jetë pjesë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. "Në mbledhjen e parë të Asamblesë, Kosova do të ftohet në cilësinë e vëzhgueses dhe do të ulet në të njëjtën tavolinë me të gjitha delegacionet e tjera anëtare të NATO-s", ka thënë ai.

Më tutje, Çeku ka shtuar se marrja e këtij statusi është përgjegjësi për Republikën e Kosovës. Sipas tij, gjatë këtij rrugëtimi do të kërkohen të plotësohen standarde dhe të ndërmerren reforma të ndryshme që do ta fuqizojnë Kosovën. "Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare nuk është vetëm privilegj, por bart edhe përgjegjësi. Kështu që, Kosova tani po fillon rrugëtimin e vet drejt anëtarësimit në NATO. Ky rrugëtim parasheh kritere, standarde që duhet të plotësohen, po ashtu parasheh reforma që duhet të ndërmerren dhe natyrisht se këto veprime vetëm se e ndihmojnë zhvillimin e Kosovës", ka deklaruar Çeku.

Ai ka folur edhe për rrugëtimin e Kosovës deri në këtë pikë, duke thënë se arritja e statusit si anëtare vëzhguese në Asamblenë e NATO-s, nuk ka qenë e lehtë.

"Republika e Kosovës me mund të madh po depërton dhe po anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, duke e ditur faktin se kemi vende që janë anëtare të NATO-s dhe BE-së e që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Çdo anëtarësim i Kosovës, qoftë edhe në statusin e vëzhguesit, është shumë i rëndësishëm, duke i ditur rrethanat politike nëpër të cilat po kalon Kosova. Kështu që, të gjitha këto bëhen me vështirësi", është shprehur Çeku, derisa ka falënderuar partnerët ndërkombëtarë për përkrahje. "Në radhë të parë për këtë meritore është Kosova që po tregon mesazhe pozitive sikurse ishte krijimi i Forcave të Armatosura, por duhet ta dimë se të gjitha këto bëhen me ndihmën e partnerëve tanë ndërkombëtarë, në radhë të parë SHBA-së dhe miqve të tjerë që i bindin të tjerët që Kosova e meriton një status të tillë", është shprehur Çeku.

Kosova vëzhguese në Asamblenë e NATO-s

Vendimin e Asamblesë së NATO-s për t'i dhënë Kosovës mundësinë për të qenë vëzhguese e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, e ka përshëndetur kryeministri i Qeverisë së Kosovës, z. Hashim Thaçi.

Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi e cilësoi si hap thelbësor për integrimin, vendimin e pranimit të Kosovës si vëzhguese në Asamblenë Parlamentare të NATO-s: "Mendoj se është një hap i rëndësishëm dhe historik për shtetin tonë të ri. Është një vlerësim gjithë ndërkombëtar për shtetin tonë, është një vlerësim i familjes euroatlantike për hapat e rëndësishëm që i ka arritur Kosova. Pra, e sotmja dhe e ardhmja e Kosovës është e ardhme euroatlantike. Urime dhe përgëzime të gjithë qytetarëve të Kosovës".

Gjeneral Farina: FSK-ja e gatshme për të kontribuar në rajon

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Farina, pranoi për herë të parë në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it në Prishtinë, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, admiralin Dragan Samarxhiç.

Në takimin, ku mori pjesë edhe Komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, u bisedua edhe për kapacitetet e FSK-së, duke nënvizuar edhe njëherë mbështetjen e NATO-së për FSK-në.

Komandanti Farina, theksoi se kapacitetet thelbësore që ka FSK e bëjnë atë të aftë të bëhet një pjesëmarrëse e rëndësishëm në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit për të kontribuar në sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Gjatë këtij takimi është biseduar edhe për situatën e sigurisë në Kosovë, e cila është konsideruar e përmirësuar pas Marrëveshjes së 19 prillit.



Komandanti i KFOR-it, duke theksuar përmirësimin e situatës së sigurisë në Kosovë pas Marrëveshjes së 19 prillit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, konfirmoi përpjekjen e vazhdueshme të misionit të NATO-s për të kontribuar në krijimin e ambient të qetë, të sigurt dhe lirinë e lëvizjes, duke krijuar kështu kushtet e nevojshme për të mbështetur dialogun dhe përparimin për të gjithë njerëzit në Kosovë, thuhet në komunikatën e KFOR-it.

Ky takim është pjesë e agjendës së bisedimeve të nivelit të lartë që mbahen në pajtim me Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake (MTU), që ndryshe njihet si Traktati i Kumanovës.

Gjeneralmajori Farina dhe Admirali Samarxhiç, përveç kësaj kanë biseduar edhe për veriun, si dhe për sigurinë në mbarë Kosovën, përfshirë këtu edhe zonën kufitare me Malin e Zi.

Rëndësi të veçantë, ata, i kushtuan bashkëpunimit të dyanshëm në mënyrë që situata e sigurisë në nivel rajonal të përmirësohet.

Gjenerali Farina falënderoi Admiralin Samarxhiç për përpjekjet e vazhdueshme që Forcat e Armatosura malazeze i bëjnë për të përmirësuar stabilitetin dhe sigurinë e përgjithshme përmes dialogut dhe bashkëpunimit me të gjithë pjesëmarrësit në rajon.

Ndërsa admirali Samarxhiç theksoi rëndësinë e "Konferencës A5" që do të mbahet në qershor të vitit 2014, ku shefat e mbrojtjes së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, ish-Republikës Federale të Maqedonisë dhe Malit të Zi, do të takohen për të diskutuar për çështjet e sigurisë dhe zhvillimin e aftësive në rajon për t'ju përgjigjur situatave emergjente.

Vendet e tjera të Ballkanit, si Sllovenia dhe Serbia, do të marrin pjesë si vëzhgues, kurse një ftesë do t'i bëhet edhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Komandanti i KFOR-i takohet rregullisht me shefat e mbrojtjes së katër vendeve që kufizohen me Zonën e Përgjegjësisë së KFOR-it, kryesisht, me Shqipërinë, ish-Republikën Federale të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Farina, pranoi për herë të parë në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it në Prishtinë, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, admiralin Dragan Samarxhiç.

Në takimin, ku mori pjesë edhe Komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, u bisedua edhe për kapacitetet e FSK-së, duke nënvizuar edhe njëherë mbështetjen e NATO-s, për FSK-në.

Ministri Agim Çeku dekorohet me medaljen "Ylli i Gjeneralit"



Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku, në një ceremoni të veçantë, mbajtur në kazermën "Adem Jashari", u dekorua me medaljen "Ylli i Gjeneralit" ndarë nga Klik Ekspo Group(KEG) i Republikës së Shqipërisë.

Medaljen në emër të Klik Ekspo Group, ministrit Agim Çeku, ia dorëzoi presidenti KEG-së, zotëri Luan Muametaj, me motivacion: "Për kontributin e dhënë për lirinë, rindërtimin, pavarësinë dhe shtet ndërtimin e Republikës së Kosovës". "Si gjeneral luftoi dhe e fitoi luftën për lirinë dhe dinjitetin njerëzor të popullit të Kosovës, si burrë shteti, kryeministër dhe politikan vizionar, përgatiti premisat për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, si reformator, udhëhoqi transformimin e UÇK-së në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, si personalitet publik, punoi për ndërtimin e paqes, stabilitetit të marrëdhënieve dhe të fqinjësisë së mire me vendet e rajonit në dobi të prosperitetit e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendeve të Ballkanit" thuhet në motivacion.

Në fjalën e rastit, gjeneral brigade Agim Lala, drejtor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, foli rreth veprimtarisë ushtarake dhe angazhimeve të ministrit Çeku që nga fillimi i karrierës së tij si ushtarak, pjesëmarrjen e tij aktive në luftën për çlirim të popullit të Kosovës, duke shtuar se ndjehet krenar që në listën e shumë personaliteteve që janë nderuar me këtë medalje, në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në vend, rajon dhe më gjerë, tani iu shtua edhe gjenerali i luftës dhe i paqes, gjenerallejtënant Agim Çeku.

Më tej gjeneral Lala th: "Gjeneral Çeku u vu në shërbim të njerëzimit me armë në dorë. Nga detyra e ushtarit të bindur deri tek gjenerali i dy ushtrive në Ballkanin e përflakur nga luftërat për liri të popujve të tij, në fundin e shekullit të kaluar". Gjeneral Lala shtoi gjithashtu se ministri Çeku, atëherë gjeneral Çeku erdhi përmes flakëve, në luftën më të lavdishme për liri të Kosovës martire, për të mos u quajtur më kurrë martire, të luftës që solli lirinë". Gjeneral Agim Lala theksoi po ashtu se Gjeneral Çeku, si organizator dhe Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në njërën nga formacionet ushtarake më të lavdishme të popullit shqiptar në shekullin njëzet, bashkë me djemtë dhe vajzat e Kosovës dhe mbarë kombin, krijuan me pushkë dhe më mendje historinë e lirisë që ne po jetojmë sot, përfundoi gjenerali Lala.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku në fjalën e tij, me rastin e dekorimit me medaljen "Ylli i Gjeneralit", u shpreh se ndjehet tejet i lumtur që këtë Yll dhe këtë nderë e merr pikërisht nga një organizatë e popullit të tij dhe kolegëve të tij gjeneralë. Ministri Çeku tha gjithashtu se e gjithë veprimtaria e tij në shërbim të kombit, luftës për çlirim të vendit është e lidhur me bashkëluftëtarë, kolegët, bashkëkombësit dhe se rezultatet dhe vlerësimet për të cilat tani u dekorua janë pjesë e punës dhe sakrificës së përbashkët. Unë, vazhdoj ministri Çeku kam qenë dhe jam i nderuar që kam pasur fatin që të jem pranë popullit tim, atëherë kur më së shumti i jam dashur atij, sepse shtoi ministri Çeku, askund si në mesin e popullit të tij nuk është ndjerë, dhe se vetëm këtu në mesin e popullit të tij, ka qenë gjenerali për të cilin ka dhënë shumë nga vetja, dhe i cili vetëm në mesin njerëzve të tij dhe bashkëluftëtarëve të tij ndjehej gjeneral. Ministri Çeku gjithashtu potencoi edhe kontributin e tij dhe shumë bashkëluftëtarëve të tij në luftën për liri të popullit kroat në Kroaci, për të cilën çmohet dhe vlerësohet vazhdimisht.

Në fund ministri Agim Çeku foli edhe për bashkëpunimin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, gjithashtu kontributin që kanë dhënë ushtarakët e Republikës së Shqipërisë në shumë fusha, si edh kontributin e popullit, djemve dhe vajzave të Shqipërisë në luftën për çlirimin e Kosovës.

Me këtë rast, ministrit Çeku iu dhurua edhe një libër i poetit shqiptar Dritëro Agolli, pikërisht nga e bija e shkrimtarit Elona Agolli, e cila edhe e lexoj para të pranishmëve dedikimin e shkrimtarit të madh Agolli, për ministrin Agim Çeku.

Medalja "Ylli i Gjeneralit" është mirënjohje e cila ndahet nga grupi "Klik Ekspo Grup" me qendër në Republikën e Shqipërisë, për ushtarakët që mbajnë gradën e gjeneralit dhe që kanë dhënë kontribute të veçanta në luftë dhe në paqe për lirinë e popujve dhe dinjitetin njerëzor. Kjo mirënjohje shpërndahet pasi shqyrtohet dhe vendoset në takimin e bordit të gjeneralëve në rezervë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët funksionojnë pranë "Klik Ekspo Group".



Zëvendësministri i MFSK-së, Muhamet Latifi mori pjesë në shënimin e përvjetorit të Betejës së Çanakalasë në Turqi

Zëvendësministri i Ministrisë për Forcat e Sigurisë së Kosovës (MFSK), zotëri Muhamet Latifi, me ftesë të ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, z. Ismet Yilmaz, më 24 prill 2014, mori pjese në ceremoninë për shënimin e 99 vjetorit të Betejës së Çanakalasë, në Turqi (Betejë të cilën e kishte udhëhequr Kemajl Mustafa Ataturk, themeluesi i Turqisë moderne).

Në ceremoninë për shënimin e Betejës së Çanakalasë, ishin të ftuar mbi 37 ministra të Mbrojtjes të shteteve të ndryshme të Botës.

Në emër të MFSK-së dhe FSK-së, zëvendësministri Muhamet Latifi, në shenjë nderimi për të rënët, bëri homazhe dhe vendosi kurora me lule. Ceremonia kryesore u mbajt në Çanakala, në vendin ku para 99 viteve u zhvillua Beteja e Çanakalasë. Kjo betejë është shënuar me aktivitete të shumta ushtarake.

Gjeneral Kastrati dekoron me medalje gjeneralin Wagner

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati ka organizuar një pritje lamtumirëse, për drejtorin e NLAT-it (Ekipit Ndërlidhës Këshillues i NATO-s), gjeneral brigade Norbert Wagner, në përfundim të misionit të tij në Kosovë.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati e ka dekoruar drejtorin e NLAT-it, gjeneral brigade Norbert Wagner, me Medalje, me motivacionin për angazhimin dhe kontributin e dhënë gjatë kryerjes së detyrës së drejtorit të NLAT-it (Ekipit Ndërlidhës Këshillues i NATO-s).

Gjeneral Kastrati fillimisht e ka falënderuar gjeneralin Wagner, për kontributin e dhënë për FSK-së, për të shtuar se: "Gjenerali Wagner ka ardhur në një kohë të rëndësishme për ne, dhe i cili e ka kryer detyrat me sukses. Ai, si drejtor i NLAT-it, ka sjellë risi, ka sjellë ndryshime dhe suksese, përmes një vizioni të qartë që kishte për ta ndihmuar FSK-në. Gjenerali Wagner do të mbetet një mik i madh i FSK-së dhe Kosovës dhe gjithmonë do të jetë i mirëseardhur në Kosovë".

Ndërsa, gjenerali Norbert Wagner, pasi pranoi Dekoratën, premtoi se do të jetë gjithmonë me FSK-në dhe Kosovën, si dhe kudo që do të shkojë, do të jetë ambasador i FSK-së dhe Kosovës. "Më vjen keq, që po duhet të largohem para kohe, para se ta kryej afatin, por, unë falënderoj të gjithë për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që kam pasur me stafin e FSK-së, për mikpritjen e shkëlqyeshme që do ta mbajë mend gjithmonë, dhe unë do të jem ambasador i juaj, kudo që do të shkojë në botë".

Në ceremoninë përcjellëse morën pjesë: gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministrat; Bejtush Gashi dhe Jasmina Vasiq, zëvendëskomandanti i KFT-së,



gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i BRSH-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i BMO-së, gjeneral brigade Ilaz Dërguti si dhe oficerë dhe drejtor të drejtorive të Ministrisë dhe FSK-së.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

U emëruan edhe tre atashe ushtarakë të FSK-së

Ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj, dhe ai i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku kanë zyrtarizuar të hënën vendimin për dërgimin e tre atasheve ushtarak të sigurisë në ambasadat e Kosovës në Shqipëri, Suedi dhe Turqi, iniciativë në përputhje të plotë me misionin e diplomacisë kosovare.





Ceremonia e emërimit të tre atasheve ushtarak u mbajt në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), në të cilën morën pjesë: ministri i MFSK-së, z. Agim Çeku, ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, z. Enver Hoxhaj, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i KFT-së, gjeneral major Rrahman Rama, si dhe përfaqësues të Ministrisë së FSK-së dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës.

Me rastin e emërimit të atasheve ushtarak, ministri Agim Çeku, tha se; "Ne së bashku me ministrin Enver Hoxhaj emëruam tre atashe ushtarak, në Shqipëri, Turqi dhe Suedi", ku synim yni është të dërgojmë atashe të përgatitur në ambasadat tona, me qëllim që të kemi një qasje më të mirë, me ato vende ku kemi bashkëpunim në nivel ambasadash.

Për mua sot, është një ditë e veçantë emërimi i tre ambasadorëve, të cilët janë të përgatitur profesionalisht në Akademinë Ushtarake të Kroacisë, në Zagreb.

"Këta atashe që i kemi propozuar i kemi përgatitur mirë. Ky është një fuqizim i bashkëpunimit tonë me vendet përkatëse. Ne i kemi zgjedhë pikërisht vendet me të cilat kemi një bashkëpunim shumë dinamik, të frytshëm dhe që është e nevojshme të kemi atashetë tonë pranë ambasadave....".

Në fund, ministri i Forcës së Sigurisë, Agim Çeku, shtoi se janë kontaktuar vendet pritëse, ku janë qartësuar detyrat dhe obligimet e atasheve ushtarak. "Ne jemi të interesuar ta rrisim këtë rrjet në përputhje edhe me nevojat tona dhe në përputhje me mundësitë tona buxhetore."

Të dy ministrat: Çeku dhe Hoxhaj, vlerësuan se emërimi i atasheve është një hap i rëndësishëm bashkëpunimi me vendet të cilat janë anëtare të NATO-s.

Ministri i Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj, shtoi se ministria që ai drejton do të vazhdojë të ketë bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Forcës së Sigurisë, shtuar se nëse do të ketë propozime të reja do t'i marrin parasysh, në mënyrë që të ketë shtrirje të gjerë të atasheve.

"Kjo kaptinë e re që është hapë, duhet të shkruhet në të ardhmen përmes vendimeve konkrete, politikave konkrete dhe një nga ato vendime është vendimi i sotëm për dërgimin e tre atasheve të sigurisë. Ne si politikë e jashtme e Kosovës do të kemi prioritet që të prezantojmë vendimin e qeverisë sa i takon themelimit të Forcave të Armatosura të Kosovës...".

Vitin e kaluar janë dërguar tre atashetë e parë të sigurisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Bruksel dhe në Gjermani, dhe nga gjashtë nga atashetë e emëruar, pesë prej tyre, janë në vendet anëtare të NATO-s, që flet për një kapitull të ri të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe NATO-s, tha në fund ministri Hoxhaj.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati dekoroi me medalje nëntoger Albert Asllanin



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dekoroi me medalje oficerin, nëntoger Albert Asllani, me rastin e përfundimit të studimeve njëvjeçare, nga 12.04.2013 deri më 14. 04 2014, në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sundhurst, të Mbretërisë së Bashkuar.

Me këtë rast, gjeneral Kastrati e përgëzoi nëntoger Asllanin për rezultate të larta gjatë shkollimit, si edhe për performancën e shkëlqyer personale dhe profesionale, si dhe për përfaqësimin dinjitoz të FSK-së, në këtë akademi. Gjeneral Kastrati me këtë rast i uroi nëntoger Asllanit shëndet dhe suksese gjatë shërbimit.

Ndërsa, nëntoger Albert Asllani e falënderoi gjeneral Kastratin për pritjen, përkrahjen si edhe për kujdesin e treguar gjatë shkollimit të tij, dhe konfirmoi angazhim të vazhdueshëm në detyrë me përkushtim dhe me njohuri dhe përvojë të re, të fituar gjatë shkollimit në Akademinë Ushtarake Mbretërore, në Sundhurst të Mbretërisë së Bashkuar.

Në emër të FSK-së, në ceremoninë e diplomimit të nëntoger Asllanit, më 14 prill ishin të pranishëm edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, zotëri Lirim Graiçevci, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi si edhe këshilltari ushtarak i KOMFSK, nënkolonel David Jones nga Mbretëria e Bashkuar.

Deri më tani, nga Forca e Sigurisë së Kosovës, këtë Akademi e kanë vijuar dhe përfunduar me sukses 9 oficerë të rinj të FSK-së, të cilët më parë kanë përfunduar studimin katërvjeçar në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së.

Komandanti i FSK-së, priti pjesëtarë të FSK-së, nga radhët e komunitet romë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me rastin e 8 Prillit, Ditës së Romëve, organizoi një pritje të veçantë për pjesëtarët e FSK-së, me përkatësi rome, si dhe për koordinatorë dhe zyrtarë të institucioneve për çështje të komuniteteve.

Gjeneral Kastrati me këtë rast i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, me përkatësi rome, për shërbimin që ata po bëjnë në FSK, duke shprehur bindjen e tij të plotë se FSK-ja është institucion i shtetit të Kosovës dhe popullit të Kosovës, dhe se të gjithë pjesëtarët e saj duhet të ndihen se janë duke punuar për institucionin e tyre dhe shtetin e tyre të përbashkët.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati gjatë takimit ua dha mundësinë pjesëtarëve të FSK-së me përkatësi rome, të shprehen mbi përvojën e tyre gjatë shërbimit në FSK, mbi raportet kolegjiale me pjesëtarët tjerë të kombit shumicë dhe komuniteteve tjera, si dhe për të gjitha çështjet që ata preokupohen gjatë punës së përditshme. Gjeneral Kastrati tha, gjithashtu, se në FSK, aktualisht, shërbejnë mbi 9 për qind pjesëtarë të pakicave dhe se FSK-ja kësaj çështje i ka kushtuar vëmendje vazhdimisht.

Nga ana e tyre edhe pjesëtarët e FSK-së, me përkatësi rome; Amir Mehmeti, Zeki Gashi dhe Gadaf Ahmeti të cilët aktualisht shërbejnë në batalionet 1, 2 dhe 3 të Reagimit të Shpejtë, ishin të hapur në bisedë me komandantin e FSK-së, duke theksuar raportet e mira ndërnjerëzore ndërmjet pjesëtarëve të FSK-së, e gjithashtu edhe të preokupimeve të njëjta të tyre. Emërues i përbashkët i të gjitha bisedave të pjesëtarëve që ishin në takim me komandantin ishin raportet e vlerësimeve, gradimeve dhe çështja e trajnimeve individuale.

Gjithashtu, Avnija Bahtijari nga Këshilli konsultativ për komunitete pranë Presidencës së Republikës së Kosovës, shprehu admirim për Ministrinë dhe FSK-në, në përfshirjen e komuniteteve si dhe në trajtimin e tyre brenda institucionit.

Ndërsa, Mehmet Jashari, nga Zyra për Komunitete në Kuvendin Komunal të Ferizajt u shpreh se komunitetet janë jashtëzakonisht të kënaqur me përfaqësimin në FSK



dhe se të rinjtë romë e duan FSK-në dhe se ka interesim për të qenë pjesë e saj në të ardhmen.

Në takimin e Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me pjesëtarët e FSK-së, me përkatësi rome, si dhe me zyrtarët për çështje të komuniteteve të disa prej institucioneve dhe komunave, mori pjesë edhe Azemina Çullum, shefe e Zyrës për Komunitete në Ministrinë për FSK dhe nënkolonel Kristian Bouveng, këshilltar për Çështje të Komuniteteve nga Ekipi Këshillues i NATOs për Ministrinë e FSK-së.

22 pjesëtarë të FSK-së udhëtuan për një trajnim 6 javësh në Bullgari



Një tog i FSK-së, prej 22 pjesëtarësh, nga kazerma e Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Pomozotin, u nis për një trajnim 6 javësh (Planifikimi i Emergjencave Civile) në Bullgari.
Qëllimi i këtij trajnimi është përgatitja e pjesëtarëve të FSK-së, në mënyrë sa më profesionale dhe sipas standardëve më të larta të kërkuara për Mbrojtjen Kimike Atomike dhe Biologjike (MKAB).
Ky trajnim po realizohet në bazë të ofertës për trajnime të Ministrisë së Mbrojtjes të Bullgarisë, që nga 28 prilli dhe do të vazhdojë deri më 07 qershor 2014.
Për të përcjellë ushtarët e FSK-së, kishin dalë komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri dhe shefi i Shtabit të Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO), nënkolonel Agron Bajrami, si dhe oficerë të lartë të FSK-së.
Me këtë rast, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), kolonel Shaip Haziri, u shprehë se ndjehet tejet i lumtur që Ministria e Mbrojtjes së Bullgarisë iu ka ofruar mundësi trajnimi të specializuar në bazat ushtarake të saj. Ky është grupi i dytë i pjesëtarëve të MKAB-së që po marrin pjesë në trajnime në Bullgari, si rezultat i bashkëpunimi dypalësh në mes FSK-së dhe Ushtrisë së Bullgarisë.
Në fund, kolonel Haziri duke u përshëndetur me pjesëtarët shprehu bindjen e tij se gjatë këtij trajnimi, ata, do të arrijnë që ta përfaqësojnë denjësisht FSK-në, sikurse edhe herëve tjera. Ai kërkoi nga ushtarët e FSK-së, që gjatë trajnimit të përfitojnë sa më shumë njohuri profesionale dhe që këto njohuri, më pastaj t'i aplikojnë me përgjegjësi dhe me profesionalizëm në Kosovë.
"Pres nga ju që të jeni të suksesshëm, të jeni të disiplinuar dhe të jeni shembull i mirë për të gjithë ato shtete pjesëmarrëse në këtë trajnim"



Përfundoi trajnimi për mbrojtje të afërt nga instruktorët e Mbretërisë së Bashkuar

Tetë anëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) nga Policia e FSK-së, përkatësisht nga Njësiti për Mbrojtje të Afërt, kanë kaluar nëpër një trajnim intensiv dyjavor për mbrojtje të afërt. Trajnimi është drejtuar nga ekspertët e Mbretërisë së Bashkuar, dhe cilësohet si trajnim themelor nëpër të cilin duhet të kalojë çdo individ i cili është i punësuar në këtë rol. Ky trajnim është përqendruar tek Policia e FSK-së, pasi që siç dihet mbas Rishikimit të Sektorit Strategjik, Policia e FSK-së është planifikuar që të marrë rol kryesor në mbrojtje të afërt të delegacioneve dhe VIP-ve, të brendshëm dhe të jashtëm.
Pjesëmarrësit gjatë këtyre dy javëve të trajnimit kanë mbuluar një gamë të gjerë temash. Si pjesë e përmbajtjes së trajnimit ishte zhvillimi i aftësive të forta dhe të buta. Aftësi të forta janë ato si mbrojtja fizike, e cila normalisht është zgjidhja e fundit, ndërsa aftësi të buta janë ato të planifikimit, ndërlidhjes, protokollit mes institucioneve etj.



Zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, me rastin e përfundimit të këtij ushtrimi, tha: "Ky trajnim është shumë i rëndësishëm për FSK-në, si dhe përmbajtja e këtij trajnimi, ishte shumë e nevojshme sepse i ka munguar FSK-së. Unë kam qenë i impresionuar me të vërtetë me atë që pash këtu, dhe çka dëshmuan pjesëtarët e FSK-së, në këtë trajnim, sidomos demonstrimi i tyre sot ishte shumë profesional".
Ndërsa, komandanti i Policisë së FSK-së, majori Shpend Zogaj, tha se: "Ekipi im, ka kryer një trajnim të mirë, që i ka munguar deri më tani, dhe pjesëtarët e policisë së FSK-së, që kanë marrë pjesë kanë mësuar shumë, si në aspektin teorik dhe praktik, për një periudhë shumë të shkurtër kohore. Tani është e rëndësishme për ne, që këto njohuri të fituara të bartim me sukses edhe tek pjesëtarët e tjerë të FSK-së, kur dihet se FSK-në, në të ardhmen e pret një rol i ri dhe një mision i ri". Në fund, major Zogaj ka falënderuar Ekipin e Instruktorëve të Mbretërisë së Bashkuar, për trajnimin e shkëlqyer dhe profesional.
Gjithashtu edhe nënkoloneli David Jones, premtoi se edhe në të ardhmen do ta mbështesim me trajnime profesionale FSK-në. " UK do të vazhdojë ta mbështesë FSK-në me trajnime të ndryshme si në Kosovë, por edhe në UK.
Pjesëtarët e FSK-së, gjegjësisht të Policisë së Forcës kanë treguar një përkushtim të madh dhe për ne, ka qenë kënaqësi të punosh me ta.
Ndërsa, instruktori Paul Neathey (instruktor për mbrojtje të afërt) tha se unë do të isha i lumtur, nëse këta pjesëtarë të FSK-së do t'i kisha për të kryer çfarëdo misioni apo detyre.
Trajnimi u përmbyll me një demonstrim final dhe me dhënien e certifikatave për përfundimin me sukses të këtij trajnimi.

Në KDS u mbajtën garat për zgjedhjen e ushtarit më të mirë



Në ambientet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, për tri ditë me radhë, u mbajtën garat për zgjedhjen e ushtarit më të mirë të FSK-së.

Për të përcjellë nga afër, këtë garë, mori pjesë komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me komandantin e KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqin, si dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati i ka përgëzuar pjesëtarët e FSK-së, për organizimin e garave për zgjedhjen e ushtarit më të mirë të FSK-së.

Gjeneral Kastrati, me këtë rast, shtoi se, këto lloj garash po mbahen për herë të parë tek ne. Gara të tilla organizon çdo ushtri, por me emër tjetër, zgjedhja e luftëtarit më të mirë. "Unë besoj, se në të ardhmen e afërt, edhe ne do të vazhdojmë me organizimin e garave të tilla.

Qëllimi ynë është përgatitja sa më e mirë e pjesëtarëve të FSK-së, sepse në të ardhmen, synimi yni është të marrin pjesë në operacione paqeruajtëse: qofshin ato humanitare, apo paqësore, me qëllim të ruajtjes së paqes në botë, që synojmë të ecim krah për krah me shtetet e NATO-s, dhe me shtet tjera që marrin pjesë në këto operacione".

Gjeneral Kastrati, në fund ka falënderuar të gjithë ata që e kanë organizuar këtë garë, ndërsa garuesit i uroi: "juve garuesve, që po merrni pjesë, ju uroj që të përfitoni sa më shumë njohuri shtesë dhe eksperiencë të mjaftueshme, sepse këtë vit, për herë të parë FSK-ja, është ftuar që të marr pjesë si vëzhguese në Kroaci, në garat e shteteve të NATO-s. Unë jam shumë i bindur që vitin e ardhshëm do të jemi pjesë aktive e këtyre garave, dhe vet kjo garë, që ne po zhvillojmë gjatë tri ditëve, është planifikuar për zgjedhjen e ushtarit më të mirë, me qëllim që të përgatitemi sa më mirë për të marrë pjesë në të ardhmen në garat rajonale apo në vendet e NATO-s".tha komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati.

Ndërsa, për rrjedhën e garave njoftoi rreshter majori Genc Metaj, i cili tha se në këtë garë po marrin pjesë 22 pjesëtarë të të gjitha njësive të FSK-së. Ditën e parë janë mbajtur garat në testimin fizik, navigim tokësor ditënatën, testimin e njohurive të përgjithshme, gjuajtje me armë të gjata, kalimin e poligonin me pengesa dhe marshimin mbi 15 km, me ngarkesa.





Certifikohen pjesëtarët e Task-Forcës të FSK-së për paramedikë



Në ambientet e Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, në Pomozatin, u bë certifikimi i 15 pjesëtarëve të Task-Forcës së FSK-së, të cilët kanë kryer me sukses një trajnim 6 javor për paramedikë të mbajtur nga ekipi i instruktorëve të Mbretërisë së Bashkuar.

Në ceremoninë e certifikimit, morën pjesë: komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar Jan Cliff, komandanti i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, komandantit i BMO-së, gjeneral brigade Ilaz Dërguti, komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri, si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe instruktorët e Mbretërisë së Bashkuar.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, fillimisht ka falënderua Mbretërinë e Bashkuar për ndihmën që po japin, për FSK-në, në trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së, ambasadorin Jan Cliff si dhe ekipin e instruktorëve për angazhimin dhe punën profesionale në mbajtjen e këtij trajnimi të avancuar për paramedikë .

Gjeneral Kastrati u shpreh mjaft i kënaqur me bashkëpunimin e mirëfilltë, ndërmjet FSK-së dhe Mbretërisë së Bashkuar.

"Synimi i FSK-së është ngritja profesionale e kapaciteteve sipas standardeve të NATO-s" ka thënë komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, ku në këtë drejtim, një kontribut të madh po jep ekipi i Instruktorëve të Mbretërisë së Bashkuar, përmes trajnimeve të shumta e që janë të një rëndësi të veçantë për FSK-në. "FSK-ja çdo ditë po avancohet më shumë me ngritjen e kapaciteteve profesionale si: në kërkim-shpëtim, deminim, paramedikë etj.

Në fund, komandanti i FSK-së ka përgëzuar pjesëtarët e certifikuar dhe ka kërkuar që me përgjegjësi dhe profesionalizëm të punojnë në realizimin e detyrave të përditshme ".

Ndërsa, komandanti i RMC-së, koloneli Shaip Haziri, tha se "Paramedikët janë ata të cilët në mënyrë të veçantë japin kontribut në vendngjarje. Në të gjitha intervenimet e Task-Forcës, ata kanë rol kyç për shpëtimin e të lënduarve. Ky trajnim i avancuar u ka sjellë pjesëtarëve të FSK-së, njohuri më të gjëra lidhur me intervenimet dhe paramedizmin. Ata kanë mësuar për qasjen e viktimës, një veprim i cili është prioritet në rastet e kërkim-shpëtimit.

Në emër të instruktorëve të Mbretërisë së Bashkuar, ka folur David Derbyshive, i cili lavdëroi interesimin dhe seriozitetin e pjesëtarëve të FSK-së, gjatë trajnimit 6 javor, si dhe arritjen profesionale të FSK-së.

Në fund, gjeneral Kastrati, ambasadori Cliff dhe gjeneral Rama, ndanë certifikata për të gjithë pjesëtarët e FSK-së pjesëmarrës të këtij trajnimi.



Gjeneral Kadri Kastrati priti pjesëtarët e FSK-së të komunitetit turk

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me rastin e Ditës së Turqve, priti sot, pjesëtarë të FSK-së, nga komuniteti turk, në ambientet e Ministrisë së FSK-së. Gjeneral Kastrati me këtë rast, uroi Ditën e tyre si dhe i përgëzoi ata për angazhimin dhe realizimin e detyrave të përgjithshme në njësitet e tyre, aty ku po punojnë.



"FSK-ja është institucioni më i besuar i gjithë qytetarëve të saj, por edhe pjesëtarëve të komuniteteve që jetojnë në Kosovë. FSK-ja ka kryer shumë projekte që janë në shërbim të qytetarëve të Kosovës, por edhe në shërbim të komuniteteve, si: ndërtimin e urave, rrugëve, shkollave, çerdheve, vizitave mjekësore" etj.

Komandanti i FSK-së, premtoi se FSK-ja edhe në të ardhmen do të angazhohet për mirëqenien e të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve dhe qytetarëve të Kosovës. "Në kuadër të FSK-së, ka edhe pjesëtarë shumë të dalluar nga radhët e komunitetit turk, të cilët me sukses po i kryejnë detyrat e oficerit, nënoficerit dhe të ushtarëve, prandaj edhe sipas programit tonë të gjithë pjesëtarët e komuniteteve me angazhimin dhe profesionalizimin e tyre, po avancohen në detyra të reja me sukses", shtoi komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati.

Në takim morri edhe këshilltari i Ushtrisë së Turqisë, për Komandantin e FSK-së, koloneli Erdal Dodurga si dhe Azemina Çullum nga Zyra për Komunitete.

Në fund, pjesëtarët e komunitetit turk, falënderuan komandantin e FSK-së, gjeneral Kadri Kastratin për pritjen dhe përkrahjen e tij, që po jep për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve.

Ministri Hoxhaj ligjëroi para kadetëve të FSK-së

Ministri i Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin dhe zëvendëskomandantin e KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrollin, vizituan Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së, ku para kadetëve dhe oficerëve të QSU-së, dhe të FSK-së, mbajti një ligjëratë me temën: Prezantimi i Kosovës jashtë. Ministri Hoxhaj ka folur për prioritetet e politikës së jashtme të Kosovës të ndërlidhura me aspektet e sigurisë. Gjatë ligjëratës, ministri Hoxhaj ndër të tjera tha se ekzistojnë katër burime të fuqisë së fortë që kryesisht i disponojnë shtetet e mëdha: sipërfaqja, numri i banorëve, kapaciteti ekonomik dhe ushtarak.



Interesimi i kadetëve për këtë temë ishte mjaftë i madh. Pas përfundimit të ligjëratës, z.Hoxhaj së bashku me eprorët e FSK-së, vizituan ambientin e QSU-së,(klasat e mësimit, bibliotekën, dhomat e gjumit) ku u njoftuan për së afërmi më mënyrën e studimit, edukimit dhe jetesës së kadetëve.

Gjeneral Cikaqi e priti komandantin e Bonstillit, kolonelin Hensley dhe shefin e NLAT-it, gjeneralin Schnittker

Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi me bashkëpunëtorë, ka pritë në takime të ndara komandantin e kampit ushtarak "Bondstill", në Sojevë, kolonel Charles T. Hensley, dhe shefin e Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës të NATO-s (NLAT), gjeneral brigade Udo Schnittker.



Komandanti i KDS-së, gjenerali Cikaqi, fillimisht, e njoftoi kolonelin Hensley, me zhvillimin e Komandës së Doktrinës, si dhe bashkëpunimin e deritashëm dhe të shkëlqyeshëm me komandën e kampit ushtarak në "Bonstilli". Gjeneral Cikaqi, pos tjerash, kërkoi nga koloneli Hansley vazhdimin e bashkëpunimin edhe në fushën e edukimit përmes kurseve të nënoficerëve të kanalit mbështetës.

Takimi i dy komandantëve u mbajt me qëllim të thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit ndërmjet Bonstillit dhe KDS-së.

Ndërsa, kolonel Charles T. Hensley, falënderoi gjeneral Cikaqin, për pritjen e bërë, dhe tha se FSK-ja po përparon gjithmonë e më shumë, ndërsa premtoi bashkëpunim edhe më të thellë edhe me Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.

Në pritje ishin edhe zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu dhe kolonel Fadil Hadergjonaj, shef i shtabit të KDS-së.

Gjeneral Cikaqi priti edhe shefin e ri të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT), gjeneral brigade Udo Schnittker

Me këtë rast, gjeneral Cikaqi e njoftoi Shefin e NLAT, me personelin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), si dhe për misionin dhe detyrat të cilat realizohen në këtë kazermë.

Takimi i sotëm kishte karakter njohës, pasi që gjeneral brigade Udo Schnittker është emëruar në detyrën e Shefit të NLAT-it. Gjatë takimit, komandanti i KDS-së gjeneral Cikaqi e njoftoi gjeneralin Schnittker edhe për të arriturat e KDS-së, me trajnimet të cilat zhvillohen nga instruktorët e KDS-së dhe nevojat për bashkëpunim të mëtejmë.



Ndërsa, shefi i ri i NLAT-it, gjenerali Schnittker, tha: "Ndjehem i mahnitur me të arriturat e KDS-së" dhe shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit me FSK-në.

Komandanti i KDS-së dhe shefi i NLAT, pas takimit, vizituan shkollat e KDS-së, ku përcollën nga afër disa nga trajnimet të cilat janë duke u realizuar, njëherësh bashkëbiseduan me pjesëtarët të cilët ishin pjesëmarrës në këto trajnime.

Në fund, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi e falënderoi gjeneralin Schnittiker, për vizitën dhe për ndihmën e vazhdueshme të ekipit të NLAT-it, që po japin për Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe në përgjithësi për FSK-në.



Nxënës dhe arsimtarë të Prishtinës, vizituan Kazermën "Skënderbeu" të KDS-së në Ferizaj

Nxënës të Gjimnazit "Sami Frashëri" nga Prishtina, së bashku me arsimtarët e tyre, kanë vizituar kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj. Nxënësit e Gjimnazit nga Prishtina janë pritë nga oficerët e KDS-së, ku janë njoftuar për misionin dhe për detyrat e përgjithshme që realizohen në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj.

Nxënësit së bashku me ushtarë kanë vizituar ambientet e shkollave të KDS-së, ku patën rastin t'i përcjellin disa nga trajnimet e realizuara në KDS-së. Nxënësit dhe arsimtarët e Prishtinës u shprehën shumë të kënaqur gjatë vizitës dhe falënderuan për pritjen e ngrohtë nga pjesëtarët e KDS-së.

Ministri i FSK-së Agim Çeku takoi atashetë ushtarakë të akredituar në Kosovë



Në ambientet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë të Kosovës (KDS/FSK), në Ferizaj, më tre prill u mbajt takimi i radhës me atashetë ushtarak të akredituar në Republikën e Kosovës dhe në rajon. Në takim morën pjesë Ministri i FSK-së z. Agim Çeku, zëvendës komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi si dhe stafi i lartë i MFSK-së dhe FSK-së.

Ministri i MFSK, z. Agim Çeku fillimisht falënderoi të gjithë atashetë për angazhimin dhe për bashkëpunimin e mirë që kanë me FSK-në, për të shtuar se rezultatet dhe të arriturat e FSK-së janë fryt i bashkëpunimit edhe me atashetë ushtarak të vendeve që kanë akreditim për Kosovë si edhe të atyre që janë të akredituar në vendet e rajonit e që kanë treguat gatishmëri për bashkëpunim.

Ministri Agim Çeku, më pastaj foli për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë, ku tha:" Qëllimi i rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë, ishte për të kryer një analizë të plotë të të gjitha aspekteve të sigurisë në Republikën e Kosovës si dhe të identifikojë nevojat e sigurisë të vendit dhe qytetarëve të saj, dhe të përcaktojë qartë rolin e secilit institucion në sektorin e sigurisë, në mënyrë që të ndajë më mirë burimet për të përmbushur qëllimet".

Ministri Çeku, më pastaj, i njoftoi atashetë e akredituar në Kosovë dhe ata rezident, edhe për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, për misionin primar që ka si dhe zhvillimin e saj, sipas standardeve ndërkombëtare. Ai shtoi: "Misioni i Forcave të Armatosura të Kosovës duhet të jetë gjithmonë i gatshëm dhe i aftë për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial, për të mbrojtur qytetarët e saj, pasurinë e tyre dhe interesat e Republikës së Kosovës, si dhe të kontribuojë në ndërtimin dhe ruajtjen rajonale dhe stabilitetit globale". Ministri ka falënderuar NATO-n, KFOR-in, NAT-in, si dhe SHBA-në për ndihmën që kanë dhënë në përgjithsi për FSK-në.

Takimin e sotëm, me atashetë ushtarak e kryesoi nënkolonel Hasan Hoxha, ushtrues detyre i drejtorit të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si organizator i takimit.

Ndërsa, për tema të caktuara referuan; zëvendës komandanti i FSK-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe Krenare Sogojeva, drejtoreshë e Drejtorisë së Departamentit Ligjor në MFSK-së.

Në takimin e sotëm morën pjesë atasheu ushtarak i Amerikës kolonel Jejms Kot, atasheun ushtarak i Republikës së Shqipërisë, kolonel Fiqri Hoxha, atasheu ushtarak i Republikës së Turqisë, kolonel Hasan Aydogdu, kolonel Luciano Palcani, atashe ushtarak i Republikës së Italisë, kolonel Dolce Kuzmanov, atashe ushtarak i Republikës së Maqedonisë, kolonel Ivica Mateshiq, atashe ushtarak i Republikës së Kroacisë, nënkolonel Kurt Jakobson atashe i Suedisë, nënkolonel Richard Parry, atashe ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar dhe nënkolonel Jan de Wolf atashe ushtarak i Mbretërisë së Holandës.

Takimet me atashetë ushtarak janë takime të rregullta dhe konfirmojnë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së MFSK-së dhe FSK-së me ushtritë e vendeve të cilat përfaqësojnë atashetë e akredituar në Republikën e Kosovës.



Ekipet mjekësore të FSK-së, ofruan shërbime mjekësore falas për qytetarët e Prishtinës

Një ekip mjekësor i FSK-së, sot ofroi shërbime mjekësore falas për qytetarët e interesuar në qendër të Prishtinës për nderë të shënimit të 7 Prillit, Ditës së Shëndetit.

Shërbime mjekësore falas nga ekipet mjekësore të FSK-së dhe të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Prishtinë u ofruan në një pikë të improvizuar në Sheshin "Nënë Tereza", me iniciativë të KUSA(Kosovo United States "Alumni") dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Gjatë ditës punën e këtyre ekipeve e vizituan edhe kolonel Xhevdet Tahiraj, shef i Departamentit të Mjekësisë të FSK-së, nënkolonel Enver Dugolli, shef i Sektorit për Bashkëpunim me institucionet në kuadër të Bashkëpunimit Civil-Ushtarak. Oficerët e lartë të MFSK-së, panë nga afër interesimin e qytetarëve për kontrollim mjekësor si dhe gatishmërinë e lartë të ekipeve mjekësore për të ofruar shërbim profesional me shumë entuziazëm.

Iniciativa e tillë tashmë është bërë. Organizatorët u shprehën mjaft të kënaqur me bashkëpunimin dhe mbështetjen profesionale dhe logjistike të FSK-së, e cila, siç thanë ata, po ofron vazhdimisht për nderë të kësaj dite dhe në të mirë të shëndetit të qytetarëve të vendit tonë.



Me nderime të larta u varros oficeri i FSK-së, kapiten Sherif Voca

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), të hënën (më 14.04.2014) me një ceremoni dinjitoze i dha lamtumirën e fundit pjesëtarit të FSK-së, kapiten Sherif Voca, i cili ndërroi jetë pas një sëmundje të rëndë. Me rastin e vdekjes së kapiten Sherif Vocës, gjatë ditës së djeshme Batalioni i Tretë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH-së) në Mitrovicë, në të cilin i ndjeri kapiten Sherif Voca, ishte komandant Kompanie, në ambientet e kazermës "Minatori" kishte organizuar homazhe në nderim të tij, ku kishin ardhur për t`u përshëndetur për herë të fundit shumë pjesëtarë të FSK-së, bashkëluftëtarë, miq dhe familjar.



Me këtë rast homazhe kanë bërë edhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade, Gëzim Hazrolli, komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejt (BRSH-së) gjeneral brigade, Nazmi Brahimaj, stafi i lartë i MFSK dhe FSK-së, komandanti i Batalionit të Tretë nënkolonel Arsim Shaqiri si dhe ushtarët e Batalionit të Tretë të BRSH-së.



Në ceremoninë e varrimit e cila u mbajt në varrezat e fshatit të lindjes, Liqej të Komunës së Vushtrrisë, në emër të FSK-së foli gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i cili në fjalën e tij lamtumirëse për kapiten Sherif Voca tha: "Ishte oficer i devotshëm, i përkushtuar dhe besnik në realizimin e objektivit tonë drejtë bërjes së Forcës së Armatosur të Kosovës. Ishte kontribuues i Lirisë së Kosovës në të gjitha fazat e zhvillimit tonë, që nga pjesëmarrja e tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), më pas dha kontributin e tij në TMK, po ashtu ishte shembull i mirë si oficer i palodhur në FSK".

Një fjalë rasti mbajti edhe përfaqësuesi i shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së Shasivar Shala i cili evokoi kujtime për jetën dhe veprimtarin e Sherif Vocës, për aktivitetin e tij gjatë luftës çlirimtare të tij dhe të familjes në përgjithësi. Të pranishmit i përshëndeti edhe vëllai i të ndjerit kapiten Sherif Vocës, i cili theksoi se "Sherifi sa ishte i familjes ishte edhe i juaji prandaj e vlerësojmë shumë pranin tuaj dhe prezencën tuaj që sot jeni këtu me ne për të ndarë dhimbjen së bashku".

Mbi varrin e kapiten Sherif Vocës u vendosën kurora lulesh nga stafi i lartë i MFSK-së, ushtarët dhe eprorët e FSK-së, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, familjarë, miq e shokë.

FSK-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Tokës me mbjelljen e drunjve dekorativë

Me rastin e 22 prillit, Ditës Ndërkombëtare të Tokës, sot FSK-ja organizoi aktivitete të ndryshme ambientale në hapësirat e kazermave të FSK-së, me mbjelljen e drunjve dekorativ, pishave dhe luleve.

Aktiviteti kryesor u mbajt në kazermën "Adem Jashari", në Prishtinë, ku morën pjesë: komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministri Bejtush Gashi, komandanti i KF'T-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, zëvendës komandanti i KF'T-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, si dhe ushtarë dhe oficerë të FSK-së.



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, simbolikisht mbolli fidanin e parë, i cili me këtë rast, tha se: "Kujdesi për mjedisin është përgjegjësia e jona e përbashkët" dhe kërkoi nga pjesëtarët e FSK-së, "që të jemi aktiv në mbrojtjen dhe kujdesin për mjedisin tonë, jo vetëm në kazerma por edhe në ambientet e përgjithshme me qëllim të përmirësimit të kualitetit dhe ambientit në të cilin jetojmë dhe punojmë. Mbjellja e pemëve, drunjve



dekorativ, pishave dhe luleve është një nga mënyrat më të mira për ta bërë më të mirë ambientin e punës dhe më cilësorë" përfundoi gjeneral Kastrati, komandant i FSK-së.


Nga një fidan e kanë mbjellë edhe zëvendësministri i FSK-së, Bejtush Gashi, komandanti i KF'T-së, gjeneralmajor Rrahman Rama si dhe oficerë të lartë të FSK-së.


Ky aksion është mbajtur në të gjitha kazermat e FSK-së. Aksionin e mbjelljes së fidanëve e kanë ndihmuar edhe pjesëtarë të NLAT-it, (Njësia Ndërlidhëse e NATO-s).

Nxënësit nga diaspora vizituan FSK-në

Forcën e Sigurisë së Kosovës e vizituan një grup i nxënësve dhe arsimtarëve që jetojnë në Austri. Grupi i përbërë prej 48 vetash u pritën nga oficerët e FSK-së, në ambientet e kazermës "Adem Jashari " në Prishtinë. Ata u përkujdesen që fëmijët të cilët vinin nga shkollat e ndryshme të Austrisë të shohin nga afër punën e pjesëtarëve të FSK-së, aktivitetet e tyre ditore, ushtrimet që ata bëjnë, si dhe shumë detaje tjera për të cilat ata shprehën interesim. Të gjitha këto, ata, patën mundësi t'i shohin të paraqitura përmes një filmi dokumentar që u shfaq në ambientet e Amfiteatrit të Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO-së). Ndërsa, për sa u përket pyetjeve të nxënësve të interesuar u përkujdes t'u jepte përgjigje kapiteni Fadil Vojvoda, nga Departamenti për Marrëdhënie Civile-Ushtarake.

Më pas grupi i nxënësve vizituan edhe Bibliotekën e FSK-së, ku edhe këtu nuk mungoi interesimi i tyre për të mësuar më shumë rreth kësaj biblioteke Pyetjeve të shumta të nxënësve iu përgjigj nënkolonel Milaim Musliu, komandanti i Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza. Ndërsa, mësuesi Osman Ademi, në fjalën e tij, duke u shprehur tejet i kënaqur për vizitën ndër të tjera tha: "Do të ishte mangësi e madhe të vizitohej Kosova e të mos vizitohej Forca e Sigurisë së Kosovës, ngase kjo forcë është ardhmëria jonë. Është kënaqësi e jashtëzakonshme t'i shohësh ushtarët tanë sa janë të përkushtuar dhe çfarë shkathtësish kanë,





këtë e pamë edhe sot këtu", u shpreh ndër të tjera mësuesi Ademi.

Kurse, disa nga nxënësit, shumë të emocionuar, shprehen se FSK-ja është institucioni i tyre i pëlqyer. Kremtim Hasani thotë: "Unë jam shumë i kënaqur që po shoh nga afër ushtarët e FSK-së, të cilët dua t'i falënderoi nga zemra, që pa asnjë hezitim u përgjigjen në të gjitha pyetjet për të cilat ne shfaqëm interesim", tha Hasani.

Në fund, oficerët e FSK-së, gjatë ndarjes nga ky grup i nxënësve, u shprehën se FSK-ja çdo herë është e hapur për bashkëpunim me qytetarët e saj kudo që ata jetojnë e posaçërisht për fëmijët që janë e ardhmja e vendit.

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 24 • Qershor 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Intervistë me ministrin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Agim Çeku

Ministri Çeku realizoi të gjitha objektivat e deklaruara në ngritjen dhe avancimin e FSK-së

Agim Çeku, për katër vite sa e ka drejtuar Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka arritur t'i realizonte të gjitha premtimet e tij, siç janë: Arritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale; Fuqizimi i Partneritetit me NATO-n; Thellimi i bashkëpunimit me ekipet e NATO-s dhe KFOR-it në Kosovë; Ngritjen dhe ndërtimin e FSK-së si forcë profesionale, apolitike, kompetente, dinamike, të disiplinuar shumetnike të ndërtuar në përputhje me standardet më të larta të NATO-s, por, me stil dhe identitet kombëtar-vendor; Partneritetin e FSK-së me Gardën Kombëtare të IOWA-s (SHBA); Ndërtimin e raporteve të partneritetit dhe mirëbesimit me forcat e armatosura të vendeve në rajon si dhe anëtarësimi dhe pjesëmarrja e Kosovës në të gjitha iniciativat dhe projektet rajonale për mbrojtje dhe siguri; Nënshkrimin e marrëveshjes SOFA me Shqipërinë; Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe hartimin e legjislacionit të ri për krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës (FAK).
Të gjitha këto të arritura janë bërë pas një pune vërtetë të madhe, profesionale dhe këmbëngulëse, të ministrit Agim Çeku dhe stafit të tij.
Për të kuptuar më shumë për të arriturat e përgjithshme të MFSK-së, zhvilluam një intervistë me ministrin Agim Çeku.

Z. ministër, me të marr detyrën e Ministrit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, prioritetet tuaja i keni shpalosur në gjashtë pika. Tani pas katër vjetësh, sa keni arrit ta realizoni planin tuaj?
Ministri Agim Çeku: Unë gjithmonë i ndërtoj prioritetet e mia duke u bazuar në vlerat kombëtare, nevojat dhe kapacitetet e vendit, si dhe anëtar të plotë të NATO-s, dhe BE-së. Po ashtu, rëndësi të veçantë në përpilimin e tyre zë edhe bashkëpunimi regjional. Vetëm kështu mund të arrihet një siguri e qëndrueshme për vendin tonë. Pastaj, këto prioritete harmonizohen me programin Qeverisës. Do të më duhet shumë kohë për të shpjeguar një proces të tillë, por me lejoni të përmend se prioritetet e mia janë realizuar, disa plotësisht e disa janë afër përfundimit sepse edhe natyra e tyre është e tillë. Çdo prioritet është proces. Nëse flasim për prioritete të natyrës teknike siç është arritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale, atëherë mund të them se është realizuar 100%, por nëse flasim për prioritete që kanë të bëjnë me anëtarësimin në disa institucione regjionale të sigurisë që kanë dalë nga iniciativat e anëtarëve të NATO-s, atëherë ky prioritet është realizuar pjesërisht. Por, në tërësi, të gjitha prioritetet kanë ecur dukshëm, ku si me më rëndësi është përfundimi me sukses i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Ministria që ju drejtoni ka dy vite që në vazhdimësi ka punuar për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë. Çfarë mund të na thoni për këtë z. ministër?
Ministri Agim Çeku: Së pari dua të them se proceset si RSSS-ja bëhen vetëm nga shtetet e pavarura dhe sovrane që kanë qëllim të jenë sa më të përgatitura dhe në hap me kohën me trendët e fundit të sigurisë.
Aplikimi i rekomandimeve është po ashtu proces i rëndësishëm sa edhe vet vlerësimi i nevojave të sigurisë. Këto rekomandime janë paraparë të aplikohen brenda një periudhe disa vjeçare. Gatishmëria e Qeverisë që të përkrahë në maksimum këtë proces është për t'u lavdëruar dhe tashmë që nga fillimi i mandatit tonë pas zgjedhjeve të 8 Qershorit, ne menjëherë do të fillojmë me aplikimin e rekomandimeve. Kjo vjen pasi që në një ndër seancat e para të Kuvendit të ri të votohet transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura.

Cilat janë arritjet e përgjithshme të FSK-së në fushën e kapaciteteve operacionale, dhe cili është bashkëpunimi me NATO-n pas plotësimit të këtyre kapaciteteve?
Ministri Agim Çeku: Kapacitetet operacionale si të përfunduara janë shpallë nga vet NATO-ja. Kjo ka ardhur si rezultat i punës së palodhshme nga ushtarët si dhe nga stafi civil. Ka qenë një prior-

→



FSK-ja gjithmonë në shërbim të vendit dhe qytetarëve të saj!

FSK-ja ka realizuar operacione dhe projekte të shumta në mbështetje të autoriteteve civile, komuniteteve dhe qytetarëve. A mund të na thoni diçka më shumë?
Ministri Agim Çeku: FSK-ja ka realizuar shumë projekte humanitare, që të gjitha në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Unë mburrem me angazhimin dhe realizimin e shumë e shumë projekteve të ndryshme që janë në shërbim të qytetarëve tanë. FSK-ja gjithkund është afër atyre, që kanë më së shumti nevojë. Ky besim është arritur me punë, me angazhim maksimal, me profesionalizëm dhe bashkëpunim në nivel lokal, qendror dhe ndërkombëtar.



itet i vendosur nga unë që është plotësuar 100%. Bashkëpunimi me NATO-n bëhet edhe nëpërmjet NLAT-tit (këshilltarëve ndërlidhës të NATO-s), si dhe nëpërmjet NAT (Këshilltarëve të NATO-s), që të dy grupet e këshilltarëve janë gjatë tërë kohës në rrjedha me çdo zhvillim të FSK-së. Ata kanë dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në plotësimin e çdo standardi që ka çuar drejt arritjes së Kapaciteteve të Plota Operacionale. Unë për këtë gjë u jam shumë falënderues dhe premtoj që ky bashkëpunim vetëm se sa do të thellohet. Fryma e NATO-s brenda forcave tona është evidente dhe askush nuk mund ta anashkaloj këtë gjë. Arritjet e FSK-së janë po ashtu arritje të NATO-s.



Ndër të arriturat më të mëdha të MFSK-së dhe FSK-së në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar është Partneriteti Shtetëror me Gardën Kombëtare të IOWA-s. A mund të thoni diçka më shumë?

Ministri Agim Çeku: Partneriteti Shtetëror me Gardën Kombëtare të IOWA-s është një ndër arritjet më të suksesshme e cila është me rëndësi jo vetëm për FSK-në, por edhe për vet shtetin tonë, sepse siç e dini nga ky partneritet kanë dalë shumë projekte bilaterale që nga fusha e bujqësisë e deri te ajo e arsimit. Ky partneritet me Gardën Kombëtare të IOWA-s shkon më tej projekteve të përbashkëta. Ne me shtetin e IOWA-s ndajmë vlera të përbashkëta për familjen, arsimin dhe respektin për veteranët e luftës.

Për herë të parë, FSK-ja ka dërguar atashe ushtarakë në shumë shtete të Botës. Sa e rëndësishme është kjo për FSK-në?

Ministri Agim Çeku: Shikoni, ne sapo kemi filluar ta shtrijmë ndikimin tonë ndërkombëtar nëpërmjet atasheve ushtarakë. Këta atashe përpos që i kanë plotësuar të gjitha kriteret e parapara, po ashtu ndihmojnë shumë edhe në fushat e tjera të bashkëpunimit përveç atyre të sigurisë. Ata janë përfaqësues të denjë, së bashku me pjesën tjetër të Ambasadave tona, që i japin mesazhin e duhur botës për vendin tonë. Ne kemi atashe në vendet më me ndikim në botë, duke filluar nga SHBA, Gjermani, Belgjikë, Turqi etj. Misioni im i ri, ndër të tjerash do të jetë edhe vazhdimi i zhvillimit të programit për dërgimin e atasheve ushtarakë në vendet e tjerat të botës që janë me interes për shtetin tonë.

Z. ministër, shumë oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, po shkollohen me sukses në shkollat ushtarake dhe në qendrat e ekselencës të NATO-s. Në cilat qendra po shkollohen pjesëtarët e FSK-së?

Ministri Agim Çeku: Për neve, shumë me rëndësi është shkollimi dhe përgatitja profesionale e pjesëtarëve të FSK-së. Në kuadër të FSK-së, me sukses po funksionon Qendra për Studime Universitare e FSK-së, ku për çdo vit përgatiten kuadro të shkolluara. Gjithashtu, ne kemi shumë oficerë që vazhdojnë specializimet në qendrat shkollore në shumë shtete të Botës, mund të përmendi, SHBA-n, Shqipërinë, Maqedoninë, Kroacinë, Turqinë, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Bullgarinë, Lituaninë etj., kemi shumë kadetë dhe oficerë të FSK-së, që po i kryejnë me sukses studimet dhe specializimet. Është një shembull shumë pozitiv, se oficerët e FSK-së, në këto qendra shkollimi po dallohen me rezultate kulmore, në mesin e shumë kadetëve të ushtrive të botës pjesëmarrëse, si dhe të shumtë janë ushtarët dhe ushtaret tona, që shpallen më të mirët në këto qendra shkollimi dhe trajnimi me prestigjiozët në Botë.

Një e arritur e madhe e FSK-së, është edhe pjesëmarrja në shumë ushtrime dhe trajnime ndërkombëtare, së bashku me ushtritë e rajonit dhe të botës. Cilat janë këto?

Ministri Agim Çeku: Me qëllim të mbajtjes së kapaciteteve operacionale të FSK-së, kemi realizuar shume aktivitete, si: stërvitje të përbashkëta, ushtrime fushore e tjera. Vetë pjesëmarrja e FSK-së në ushtrimet e përbashkëta me ushtritë e rajonit dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është një ngjarje jashtëzakonisht e rëndësishme për ne. Pjesëmarrja e kadetëve të FSK-së, në Krivollak të Maqedonisë së bashku me kadetët e ushtrive të rajonit ka qenë një ngjarje e rëndësishme, sepse kadetët tanë kanë treguan se janë një forcë e përgatitur mirë, një force profesionale dhe e cila mund të krahasohet me të gjitha ushtritë e rajonit dhe ushtritë e NATO-s. FSK-ja është duke u zhvilluar dhe trajnuar në bazë të standardeve të NATO-s dhe në partneritet dhe bashkëpunim me vendet e rajonit dhe SHBA-s. Edhe gjatë vitit të kaluar, kemi realizuar shumë stërvitje dhe ushtrime të përbashkëta fushore me ushtritë e rajonit, këtu, mund të përmendi, stërvitjen e mbajtur në Shqipëri, e ashtuquajtura "Joint Reaction 13", pastaj ushtrimi i përbashkët fushor në Krivollak të Maqedonisë, "Shared Resilience 13" për menaxhimin e katastrofave, që kishte për qëllim rritjen e kapaciteteve të vendeve të A-5 dhe rajonit për krijimin e kapaciteteve të përbashkëta, me qëllim të menaxhimit të shpejtë të situatave të ndryshme të krijuara, qofshin këto emergjenca civile apo aksidente të ndryshme. Objektivat e kësaj stërvitje ishin: Kuptimi dhe përdorimi i procedurave të përbashkëta për përballimin e situatave, Rritja e ndërveprimit të personelit dhe pajisjeve, Zbatimi i procedurave standarde të veprimit për operacionet e kërkim-shpëtimit, Aplikimi i procedurave të NATO-s, Vlerësimi i kapaciteteve ushtarake në operacionet e kërkim-shpëtimit, etj. Pjesëmarrja e FSK-së, në ushtrimet rajonale po kontribuon në sigurinë rajonale dhe fuqizimin e bashkëpunimit në mes të shteteve të Rajonit.

Ju si ministër i MFSK-së, keni marrë pjesë në shumë konferenca rajonale dhe ndërkombëtare. Çfarë mund të na thoni më konkretisht?

Ministri Agim Çeku: Njëri nga objektivat e Ministrisë për


→



Ekipet e deminimit kanë pastruar mbi 880.488 metra katror fusha të minuara

Ju e përmendët deminimin, një fushë shumë e rrezikshme që u ka sjellë shumë fatkeqësi qytetarëve të Kosovës. Në Kosovë ka pasur shumë fusha të minuara dhe mjete të tjera të pashpërthyera që nga pas lufta të mbetura nga forcat serbe, por edhe shumë mjete të pashpërthyera me rastin e bombardimeve të NATO-s, mbi caqet serbe. Minat dhe mjetet e pashpërthyera paraqesin rrezik të madh për qytetarët e Kosovës, kur dihet se në vitin 1999 janë regjistruar mbi 4500 fusha të rrezikshme dhe fatkeqësisht nga to kanë humbur jetën mbi 114 veta dhe mbi 450 qytetarë kanë mbetur të lënduar. Njësitet tona të deminit janë njësi elite në këtë fushë të trajnuar mirë dhe kanë përvojën më të mirë në rajon. Këtë e kanë dëshmuar me punë dhe profesionalizimin. Që nga viti 2010, deminerët e FSK-së kanë pastruar mbi 880.488 metra katror dhe kanë shkatërruar mbi 1104 mina dhe mjete tjera shpërthyese.

FSK-ja ka edhe dy njësi të deminimit që kujdestarojnë 24 orë në ditë, për intervenime në rastet kur qytetarët hasin në mjete të ndryshme eksplozive dhe lajmërojnë për largimin e tyre. Këto ekipe kanë intervenuar në 1269 raste dhe kanë demoluar 2096 mjete të ndryshme eksplozive. Vlen të përmendet bashkëpunimi i FSK-së, me Ushtrinë e Suedisë, në lëmine e deminimit. Vitin e kaluar Kompania e deminimit të FSK-së, në bashkëpunim me Regjimentin "Gota" të Ushtrisë të Suedisë, (me makineri të rëndë) e kanë pastruar Parkun e Gërmisë, në Prishtinë, nga minat dhe mjeteve tjera të pashpërthyera.



Ndërtimi i urave mobile

FSK-ja për herë të parë, vitin e kaluar e ka ngritur urën mobile mbi lumin Drini i Bardhë, në një afat rekord, që lidh aksin rrugor Klinë-Gjakovë. (e gjatë 55 metra e gjerë 5 metra). Kjo është një punë shumë profesionale që e kanë bërë pjesëtarët e Xhenios të FSK-së, të ndihmuar nga KFOR-i zviceran. Pastaj, FSK-ja ka ngritur edhe dy ura për këmbësorë në Manastirin e Deçanit të cilat janë në shërbim të komuniteteve. Ditë më parë FSK-ja, gjithashtu ka ngritur edhe një urë mbi lumin Drini i Bardhë, në fshatin Krushevë e Vogël, komuna e Klinës, gati e përmasave të urës së parë (33 metra të gjatë dhe 4.5 metra e gjerë). Kjo dëshmon se FSK-ja gjithkund është afër qytetarëve të Kosovës dhe punon për qytetarët e saj.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Forcën e Sigurisë së Kosovës, ka qenë bërja e FSK-së "Forcë për të mirë" në rajon. Qëllimi ynë ishte anëtarësimi dhe pjesëmarrja e Kosovës në të gjitha iniciativat dhe projektet rajonale për mbrojtje dhe siguri, që njëherë ka qenë dhe mbetet objektiv strategjik i MFSK-së, në fushën e bashkëpunimit, të cilin e kemi realizuar plotësisht. Unë si ministër i MFSK-së, kam marrë pjesë në shumë Konferenca Rajonale dhe Ndërkombëtare për Siguri, siç janë: A-5, SEEDM, SEEBRIG dhe RACVIAC, P.sh. Pjesëmarrja në: Sfidat e Sigurisë së Adriatikut dhe Jonit, mbajtur në Tiranë, Konferenca e Ministrave të Mbrojtjes së Kartës së Adriatikut në Ohër, Konferencën për Siguri në Munih të Gjermanisë, Konferencën Ndërkombëtare për Hapësirën dhe Forcën Ajrore në Stamboll, Konferencën dhe Panairin e Mbrojtjes dhe Hapësirës Ajrore e Detare në Split, në Takimin e Drejtorëve të Politikave dhe Planeve të Kartës së Adriatikut në Podgoricë, Konferenca e 21-të Vjetore e Ushtrive të Evropës në Wiesbaden, Gjermani, Takimi Ministerial gjithëpërfshirës Rajonal në Brdo, Slloveni dhe organizimin e Konferencës "South Eastern Europe: through inclusive regional cooperation towards European Integration", mbajtur në Prishtinë.
Pjesëmarrja e MFSK-FSK-së, në këto konferenca rajonale dhe ndërkombëtare do të thotë shumë, sepse është një hap i rëndësishëm drejt anëtarësimit të plotë në strukturat ushtarake të NATO-s. Ky objektiv imi është drejt realizimit të plotë, pasi që, kohë më parë, Kosova - FSK-ja është pranuar si vëzhguese në NATO.



Z. ministër, FSK-ja është vlerësuar si institucion shumë i besueshëm për qytetarët e saj dhe partnerët ndërkombëtarë. Si është arritur ky besim?

Ministri Agim Çeku: FSK-ja është institucioni më i besueshëm për qytetarët e Kosovës. Forca e Sigurisë së Kosovës është një prej tregimeve më të rëndësishme dhe të suksesshme të Kosovës së Pavarur, këtë e konfirmojnë edhe hulumtimet e fundit, prej të cilave FSK-ja aktualisht është institucioni më i besueshëm për qytetarët e vendit tonë. FSK-ja falë rezultateve, vizionit dhe realizimit të objektivave ka fituar besimin e plotë të qytetarëve të saj, sepse Ajo është në shërbim të gjithë qytetarëve dhe në shërbim të komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Në kuadër të realizimit të objektivave të mija gjatë mandatit tim, dhe të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare kemi arritur që të realizojmë një varg projektesh të infrastrukturës, projekte humanitare, operacione të reagimit me rastin e fatkeqësive natyrore dhe të besimit të plotë të qytetarëve të Kosovës, etj.

Sa dëshmohet Forca e Sigurisë së Kosovës për ndërtimin e identitetit kombëtar dhe kultivimin e vlerave të luftës?

Ministri Agim Çeku: Si objektiv i imi ka qenë ngritja e FSK-së, në bazë të standardeve të NATO-s, por me elementet të identitetit vendor dhe jam i përcaktuar për kultivimin e vlerave të luftës. FSK-ja, tashmë ka të përcaktuar formën dhe dizajnin e simboleve, gradave, uniformave të cilat kanë filluar t'i barten që nga 27 Nëntori i vitit 2012, pastaj, sipas këtyre vlerave ne i kemi bërë emërtimin e kazermave dhe të njësive. Ne jemi fuqimisht të përcaktuar që të vazhdojmë ta ruajmë traditën tonë të ngritjes së vazhdueshme në profesion, ashtu që viti i ardhshëm të na çoj më afër realizimit të objektivave të përcaktuar nga ne.

Z. ministër, dy nga ngjarjet e një rëndësie të veçantë për Ministrinë dhe FSK-në, janë nënshkrimi i Marrëveshjes "SOFA" me Republikën e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrja e FSK-së në Paradën Ushtarake në 100-Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Si i shihni këto dy ngjarje?

Ministri Agim Çeku: Nënshkrimi Marrëveshjes SOFA dhe pjesëmarrja e FSK-së, në Paradën me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë janë dy nga ngjarjet më të rëndësishme për FSK-në. Nënshkrimi i Marrëveshjes "SOFA" me ministrin Imami të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë në Prizren, konsiderohet shumë e rëndësishme jo vetëm për FSK-në, por edhe për Kosovën. Marrëveshja "SOFA" është një marrëveshje ushtarake që rregullon proceduarat standarde të hyrjes-daljes, qëndrimit të përkohshëm dhe statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të FSK-së, në territoret e shtetit përkatës. Edhe pjesëmarrja e FSK-së, në Paradën e shënimit të 100 -vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në Tiranë ishte shumë domethënëse për ne, sepse për herë të parë FSK-ja parakaloi në bulevardin "Dëshmorët e Kombit " në Tiranë, me shumë sukses.
65 ushtarë dhe 11 ushtare ishin krenaria jonë. Ata u dalluan në të gjitha pikëpamjet. Kjo për ne ishte një mrekulli. Por, kur jemi te parakalimet, jo vetëm unë që po e them, por edhe ekspertët e kanë përgëzuar FSK-në, për Paradën e shkëlqyeshme në

FSK-ja çdo vit dhuron qindra doza gjak

Dhurimi vullnetar i gjakut në MFSK dhe FSK, tani është bërë tradicional, ku pjesëtarët e FSK-së, krahas punëve tjera që bëjnë në shërbim të atdheut i përgjigjen maksimalisht edhe aksionit human për dhurimin e gjakut. Ushtarët e FSK-së, gjithmonë janë në shërbim të qytetarëve dhe atdheut, sepse një pikë gjak e dhuruar është një jetë e shpëtuar. Aksioni për dhurimin e gjakut mbahet çdo vit në të gjitha Kazermat e FSK-së, dhe ku dhurohen qindra doza gjaku, nga pjesëtarët e FSK-së, për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, të cilat doza, janë në shërbim të gjithë atyre qytetarëve që kanë nevojë, më së shumti për të, etj.



Tiranë dhe në qendër të Prishtinës, në shënimin e Pesëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, si dhe me ritëm të njëjtë shënuam 15- vjetorin e Epopesë së UÇK-së, në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Këto ngjarje dëshmuan se FSK-ja ka arrit nivel të lartë të profesionalizimit, me çka ne të gjithë krenohemi .

Z. ministër, cili është niveli i bashkëpunimit të FSK-së, me qytetarët dhe organizatat tjera joqeveritare?

Ministri Agim Çeku: Funksionimi i një institucioni ushtarak në kohët moderne lidhet ngushtë me zhvillimin e marrëdhënieve me qytetarët dhe shoqërinë civile. Afërsia dhe transparenca janë dy gjëra elementare që e bëjnë një institucion ushtarak të jetë gjithmonë pranë nevojave të qytetarëve dhe anasjelltas. Kjo lidhshmëri bëhet përmes Departamentin për Bashkëpunim Civil-Ushtarak (BCU), i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së FSK-së. Ky departament ka për qëllim, që përmes aktiviteteve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me të gjitha institucionet dhe shoqërinë civile, të krijojë një imazh të mirë për FSK-në. Misioni i Departamentit Civil-Ushtarak është bashkërenditja e aktiviteteve ndërmjet FSK-së dhe autoriteteve civile, duke përfshirë popullatën, organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe agjencitë vendore e ndërkombëtare, me qëllim të reagimit ndaj krizave të ndryshme në Republikën e Kosovës. Kontributi ndaj shoqërisë civile është jo vetëm vizion, por edhe një realitet i prekshëm në të gjithë veprimtarinë e FSK-së. FSK-ja me kapacitetet e saj, ka ofruar ndihmë dhe mbështetje jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë. Ky është treguesi më i mirë në vlerësimin e kapaciteteve që FSK-ja ka arritur.

Z. Ministër ju jeni të angazhuar edhe në krye të Komisionit për Verifikimin e Veteranëve të UÇK-së. Si po ecë ky proces?

Ministri Agim Çeku: Jam emëruar kryetar i Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve, invalidëve dhe të pjesëtarëve tjerë të

→

FSK-ja me Njësit të Kërkim-Shpëtimit rajonal

Themelimi i Njësitit të Kërkim-Shpëtimit dhe Qendrës Regjionale të Task Forcës për trajnime ka qenë një nga objektivat e mia, që po realizohet. Njësiti rajonal i Kërkim-Shpëtimit është edhe një sukses i FSK-së, ndërsa, ngritja, profesionalizimi dhe zhvillimi i njësisë së Kërkim-Shpëtimit ka shënuar progres të madh. Në këtë aspekt deri me tani është definuar dhe aprovuar struktura e Kompanisë së Kërkim- Shpëtimit, është përzgjedhur personeli i paraparë në strukturë, janë klasifikuar pajisjet ekzistuese në ketë kompani sipas standardeve të UN-INSARAG. Qendra Regjionale e Task Forcës për trajnime të Kërkim-Shpëtimit, po realizohet me sukses, që ka qenë edhe një nga synimet e mia dhe objektivat që ka pasur Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Formimi i këtij njësiti është bërë me ndihmën e drejtpërdrejtë të



SHBA-s.
Intervenimet e pjesëtarëve të FSK-së edhe jashtë vendit.
Ministria për Forcën Sigurisë gjatë vitit 2010 angazhoi njësitet e kërkim-shpëtimit gjatë përmbytjeve në Shkodër, për t'iu dalë në ndihmë autoriteteve shqiptare dhe popullatës civile. Ky hap i FSK-së, gjeti përkrahjen dhe mbështetjen e nevojshme nga të gjithë faktorët vendorë dhe ndërkombëtarë. Disiplina, përkushtimi dhe profesionalizmi i pjesëtarëve të FSK-së, që u përfshinë në këtë mision humanitar jashtë vendit ishte një vepër e madhe e cila u çmua shumë lartë nga autoritetet më të larta shtetërore shqiptare dhe nga popullata e Shkodrës me rrethinë, si dhe nga autoritetet ndërkombëtare në Kosove dhe jashtë saj.

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga kryeministri i Qeverisë së Kosovës, z. Hashim Thaçi. Ta udhëheqësh Komisionin për Verifikimin e Veteranëve ka qenë një sfidë, jo edhe aq e lehtë, por me një bashkëpunim dhe angazhim maksimal të anëtarëve të këtij komisioni, Kryesisë së Veteranëve në Prishtinë dhe të qyteteve tjera të Kosovës, është arrit një punë e madhe në drejtim të verifikimit dhe kategorizimit të tyre, duke e ditur se konkurrenca ka qenë shumë e madhe, mbi 60 mijë veta kanë aplikua për njohjen e statutit të veteranit, invalidëve, dëshmorëve, etj. Procesi i verifikimit të veteranëve të UÇK-së, është në fazën finale, pasi që shumica e Zonave Operative këtë proces tani e kanë përfunduar. Listat do të bëhen publike që të kemi një listë vërtetë të saktë dhe të pranueshme. Ne mendojmë se deri kah fundi i qershorit apo më së largu deri në fillim të korrikut do të përmbyllet ky proces.

Sa është e pajisur FSK-ja me autoblinda, armatim dhe pajisje të tjera të sofistikuara?

Ministri Agim Çeku: Tani, FSK-ja ka armatim të lehtë, armë më bashkëkohore, armët më të mira. FSK-ja është e pajisur me armatim të gjatë dhe armë të brezit. Armët e gjata janë "HECKLER & CO", dhe "Glock, pra, armatimi i FSK-së është me standardeve të NATO-s. FSK-ja çdo vit përfiton ndihma financiare në fushën e industrisë ushtarake, e të cilat shfrytëzohen për të blerë të pajisjeve ushtarake nga Turqia. Kemi filluar që të pajisemi edhe me autoblinda tash për tash i kemi pesë autoblinda si dhe me pajisje rezervë dhe pajisje për mirëmbajtje të autoblindave.

Z. ministër, cili është mesazhi juaj për qytetarët e Kosovës?

Ministri Agim Çeku: Të nderuar qytetarë të Kosovës!.

Ky është vit i zhvillimit të FSK-së. Vit i plotësimit të Kapaciteteve të Plota Operacionale. Vit i konfirmimit se FSK-ja është plotësisht e aftë për kryerjen e misioneve të saja kryesore në mënyrë profesionale dhe të pavarur. Vit që hapi një kapitull të ri për zhvillimin e mëtutjeshëm të Forcës së Kosovës. Vit i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Vit i procesit që përcakton kapacitetet që janë të nevojshme për t'u garantuar siguria e shtetit tonë në të ardhmen. Ky është rezultat i punës sonë të përkushtuar, që nga dita e parë e themelimit të FSK-së.

Në zhvillimin tonë të mëtutjeshëm, ne bashkëpunojmë ngushtë më miqtë dhe partnerët tanë të cilëve u jemi shumë mirënjohës për mbështetjen e tyre. Ne kemi shumë arsye për të cilat duhet krenuar, ndonëse ende ka shumë për t'u bërë. Forca është një forcë për të mirë, e cila ofron mbështetje për të gjithë qytetarët e shtetit tonë dhe është e gatshme për të ndihmuar të gjithë ata që kanë nevojë në nivelin shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar.

Në fund, më lejoni që t'i falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për përkrahjen pa rezervë për Forcat tona, dhe dua t'ju sigurojë se, Misioni i ri vetëm se ka filluar. Qytetarët e meritojnë të kenë Forcat e tyre të armatosura dhe kjo gjë po realizohet.















Intervenimet në hapjen e rrugëve nga bora dhe ujëra

Intervenimi i njësiteve të FSK-së, në fshatin Restelicë, në operacionin e dhënies së ndihmës për qytetarët e kësaj treve, pas shembje së ortekut të borës, ku pjesëtarët e FSK-së, arritën që të nxjerrin të gjallë, Amsera Reka, 5 vjeçe, vajza e vetme e familjes Reka, intervenimi pas përmbytjeve të mëdha të shtëpive në Komunën e Klinës, Gjakovës, Pejës dhe Skenderajt, ku ekipet e specializuara të FSK-së, arrijnë t'i shpëtojnë shumë



qytetarë. Edhe përkundër ekspozimit të situatave mjaft komplekse, sukseset e FSK-së, në të gjitha operacionet flasin më së miri për disiplinën, përkushtimin, vullnetin dhe profesionalizmin e njësiteve të Kërkim-shpëtimit, në ujëra, në male, të zjarrfikësve etj. FSK-ja, ka realizuar shumë projekte në shërbim të të gjithë qytetarëve në Kosovë, pa marrë parasysh bazën etnike, religjioze dhe regjionale, si hapjen dhe meremetimin e rrugëve, ndërtimin dhe meremetimin e shtëpive, meremetimin e çerdheve për fëmijë, ndihma dhe asistenca mjekësore për komunitete, realizimi edhe i shumë projekteve të tjera, në të gjitha vendbanimet e Kosovës.

FSK-ja në mbështetje të projekteve qeveritare

Natyra e disa projekteve të nivelit kombëtar, siç janë: operacionet e çminimit, mbrojtjes kimike-atomike-biologjike, kërkim-shpëtimit urban, malor, ujor etj, i bëjnë të veçanta edhe angazhimet e FSK-së. Inspektimi, mirëmbajtja dhe largimi apo eliminimi i materieve të ndryshme kimike, janë detyra që kryen pjesëtarët e Kompanisë për Mbrojtje Kimike-Atomike-Biologjike. Përfitimet që kanë qytetarët dhe institucionet e ndryshme, nga ato lokale e deri te ato qendrore, është shumë i madh. Përpos inspektimeve rutinë, kjo njësi intervenon edhe mbi bazën e kërkesave nga institucionet dhe qytetarët e Kosovës.

Marrëveshje bashkëpunimi në mes Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve dhe MFSK-së

Ministri i MFSK, Agim Çeku dhe zëvendës ambasadorja e SHBA-s, në Republikën e Kosovës, Jennifer Bachus, më 8 maj 2014, në ambientet e Ministrisë, nënshkruan Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo Marrëveshje ka për qëllim krijimin e kushteve themelore dhe procedurave tjera për të lehtësuar ofrimin reciprok të mbështetjes logjistike, furnizimeve, dhe shërbimeve të tjera, kryesisht gjatë ushtrimeve të kombinuara, trajnimeve, dërgimit-dislokimit të trupave, transportit detar, operacioneve, por edhe në rastet e tjera të bashkëpunimit si në rrethana të paparashikuara ose urgjencave në të cilat njëra prej palëve mund të ketë nevojë për mbështetje logjistike, furnizime, dhe shërbime.

Gjatë takimit, të dyja palët janë pajtuar, që në kuadër të bashkëpunimit në mes të Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, të vazhdojë bashkëpunimi për furnizim dhe shërbime të ndërsjella në mes të Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Mbështetja logjistike, furnizimi dhe ofrimi i shërbimeve, sipas kësaj Marrëveshje, do të bëhet në përputhje me rregullat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Marrëveshja ka përcaktuar kushtet në bazë të të cilave të dyja palët do t'i realizojnë të drejtat dhe do t'i përmbushin detyrimet/obligimet e tyre, ku secila palë do të bëjë përpjekjet e saj, në përputhje me prioritetet kombëtare, për të përmbushur kërkesat e palës tjetër.



Presidentja Atifete Jahjaga dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, vizituan Qendrën për Studime Universitare të FSK-së

Presidentja e Republikës së Kosovës, z. Atifete Jahjaga, më 2 maj 2014, vizitoi Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së, ku u prit nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe kadetët e kësaj qendre. Fillimisht, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati e përgëzoi presidenten Jahjaga, për vizitën e saj, si dhe i njoftoi kadetët për qëllimin e ardhjes së saj në QSU.

Presidentja Jahjaga me këtë rast, tha se: Gëzohem që sot jam në mesin tuaj. Fillimisht për t'iu përgëzuar juve dhe paraardhësit tuaj për punën e palodhshme, për përkushtimin tuaj që e keni bërë për ngritjen e këtij institucioni qenësor për të ardhmen e Republikës së Kosovës, dhe pastaj për të diskutuar me ju për punën e madhe që po na pret për krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Ju e dini mirë se për çdo institucion që është krijuar në Kosovën e



pasluftës se sa sfidues është çdo fillim. I tillë ishte edhe rrugëtimi i qytetarëve tanë për të realizuar ëndrrën e gjeneratave të tëra për të ndërtuar një Kosovë që frymon lirshëm, një shtet të lirë, shtet të pavarur, shtet sovran.

Këto sfida që na dolën përpara, ne, si institucione dhe shoqëri, i kemi tejkaluar me një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Forca e Sigurisë së Kosovës ka qenë shtyllë e këtij rrugëtimi tonë - gjithëpërfshirëse, patriotike, profesionale, shumë e besueshme. Nuk është e rastësishme që sot po e ndërtojmë vizionin i cili do të shtojë obligimet tuaja, sepse si qytetarë të Kosovës, pavarësisht nga prejardhja etnike, ne besojmë në ju dhe në misionin fisnik që ju e keni ndërmarrë për ta mbrojtur Kosovën, për t'i ruajtur vlerat e idealet mbi të cilat u betuam dhe për të avancuar bashkëpunimin me aleatët tanë strategjik.

Këtu qëndron edhe suksesi i reformimit dhe profesionalizimit tuaj të mëtutjeshëm. Ai është i garantuar falë guximit, kurajës, durimit dhe zotimit tuaj për ta përmbushur misionin tuaj". Presidentja Jahjaga, më pastaj, shtoi: "Në ditët në vijim, Kuvendi i Kosovës do të diskutojë ndryshimet kushtetuese që lidhen me krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Si në çdo demokraci, edhe te ne ky proces nuk ka kaluar pa kundërthënie. Dhe në këtë kontekst, dua t'ua rikujtoj të gjithëve se ky proces duhet të përmbyllet me formimin e forcës tonë mbrojtëse.

Krijimi i Forcave të Armatosura është domosdoshmëri dhe ky opsion nuk ka alternativë. Kjo forcë është e Kosovës dhe për Kosovën. Kosova do ta ketë forcën e vet mbrojtëse, e cila do ta kompletojë konsolidimin tonë si shtet dhe do të bëhet kontribuuese e sigurisë kolektive të Evropës".

Në fund, presidentja, duke ju drejtuar kadetëve shtoi: "Ju kadetë do të jeni jo vetëm përfituesit e trajnimeve dhe shkollimit profesional me standarde të NATO-s, por edhe shtylla e Forcës tonë të Armatosur. Jam shumë krenare për arritjet tuaja dhe me padurim pres ditën kur ju do ta integroni Kosovën në Aleancën Veri-Atlantike".

Presidentja, Atifete Jahjaga dhe komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati, u ulën në mesin e kadetëve dhe biseduan shtruar me ta, për të arriturat e deritanishme dhe për të ardhmen e Qendrës për Studime Universitare të Kosovës, për FSK-në dhe për FAK-un. Po ashtu edhe kadetët i shtuan një varg pyetjesh presidentes Jahjaga, lidhur me Forcat e Armatosura të Kosovës..

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati u prit me nderime të larta ushtarake në Suedi

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së) gjenerallejtënant Kadri Kastrati i ftuar nga Komandanti i Forcave të Armatosura të Suedisë gjenerallejtënant Jan Salestrand nga data 19-22 maj 2014, qëndroi për vizitë zyrtare në Suedi.

Qëllimi i vizitës ishte zhvillimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit mes dy forcave, Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së) dhe Forcave të Armatosura të Suedisë (FAS). Komandanti i FSK-se gjatë vizitës zyrtare në Suedi, kërkoi mbështetjen e mëtejshme te Suedisë me këshilltarët në Ekipin Këshillues të NATO-s (NAT) dhe Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT). Kurse, në fokus te takimeve ishte përkrahja e Forcave te Armatosura të Suedisë, sidomos në ngritjen e Njësisë Rajonale të Kërkim - Shpëtimit dhe Qendrës së Ekselencës, duke përkrahur trajnimin e instruktorëve, mbështetja me pajisje dhe përkrahja për trajnimin dhe certifikimin e stafit të Njësisë Rajonale të Kërkim Shpëtimit nga INSARAG.

Komandanti i FSK-se me delegacionin e tij, gjithashtu, zhvilloi takime edhe me ushtruesin e detyrës së Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura të Suedisë, gjenerallejtënant Jan Salestrand, pastaj takoi



Sekretarin e Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes, Carl von der Esch dhe Shefin e Shtabit të Armatës Suedeze, gjeneralmajor Anders Brannstrom.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati vizitoi edhe Regjimentin e Gardës Kombëtare ku u prit me nderime të larta ushtarake. Ai, në Gardën Kombëtare të Suedisë, u njoftua më për së afërmi me strukturën, misionin dhe aftësitë mobilizuese dhe nivelin profesional të saj.

Komandantin Kadri Kastrati gjatë kësaj vizite e shoqëruan edhe drejtori i Operacioneve në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi, këshilltari ushtarak nënkolonel Fadil Hoxha dhe i caktuari në detyrën e atasheut të FSK-së në Suedi majori Sefer Shyti.

Pas përfundimit të vizitës në Suedi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati do të vizitojë edhe Kroacinë, ku do të merr pjesë në aktivitetin e zgjedhjes së ushtarit më të mirë në kuadër të ushtrive të NATO-s.

Komandanti i Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneral Hulusi Akar qëndroi për vizitë në MFSK

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 7 maj 2014, priti në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, komandantin e Komandës së Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneralin me katër yje Hulusi Akar me bashkëpunëtorë. Për gjeneralin Akar u organizua pritje zyrtare me togun ceremonial të FSK-së dhe me intonimin e himneve të dyja shteteve, Republikës së Kosovës dhe asaj të Turqisë.

Në takimin e përbashkët, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, e njoftoj gjeneralin Akar mbi zhvillimin dhe të arriturat e Forcës së Sigurisë së Kosovës deri në këtë fazë në të cilën aktualisht gjendemi. Gjithashtu, gjeneral Kastrati e falënderoi gjeneralin



Hulusi Akar dhe delegacionin turk për rezultatet dhe dobitë e FSK-së si rezultat i bashkëpunimit dhe koordinimit në shumë fusha të precizuara edhe me marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet të dyja ministrive dhe të dyja forcave.

Komandanti i FSK-së e njoftoi mysafirin edhe mbi procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Kosovës(RSSS) dhe çështje tjera relevante mbi FSK-në dhe bashkëpunimin Kosovë-Turqi në fushën e sigurisë. Për RSSS dhe rekomandimet e dala nga procesi një prezantim para delegacionit turk e paraqiti, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli.

Nga ana e tij, gjenerali me katër yje Hulusi Akar u shpreh i lumtur që gjendet në mes miqsh, duke folur për gatishmërinë për mbështetje edhe më tutje të FSK-së, me shkollime, trajnime si dhe pajisje, njëkohësisht shprehu mbështetjen për Kosovën edhe në mekanizmat ndërkombëtarë dhe në NATO. Ai, tha gjithashtu se ne jemi të gatshëm që t'ju mbështesim fuqishëm edhe më tutje në realizimin e objektivave tuaja.

Delegacioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në krye me gjeneralin Hulusi Akar u taku edhe me ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çekun, me të cilin biseduan rreth bashkëpunimit të mëtutjeshëm të dy ministrive dhe të dyja Forcave.

Në pritje të gjeneralit turk, ishin të pranishëm edhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral major Rrahman Rama, gjeneral brigade Bashkim Jashari, gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi si dhe Kolonel Hasan Hoxha.

Vizita e komandantit të Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralit me katër yje Hulusi Akar në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, u zhvillua në kuadër të frymës së mirë të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati priti komandantin e Komponentit Tokësor të Forcave të Armatosura të Suedisë, gjeneralbrigade Stefan Andersson

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati , më 5 maj 2014, priti në takim në Ministri, komandantin e Komponentit Tokësor pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Suedisë, gjeneral brigade Stefan Andersson me bashkëpunëtorë.

Me këtë rast, komandant Kastrati e njoftoi gjeneralin suedez mbi zhvillimet në FSK, të arriturat, profesionalizimin, operacionet, stërvitjet si dhe me një varg temash të rëndësishme rreth realizimit të objektivave dhe planeve për të ardhmen. Në fjalën e tij gjeneral Kastrati u fokusua në bashkëpunimin me Forcat e Armatosura (FA) të Suedisë, me ç 'rast e falënderoi gjeneralin Anderson dhe shtetin e Suedisë për mbështetjen dhe përkrahjen, që Forcat e Armatosura të tyre i kanë dhënë FSK-së dhe Kosovës, në disa projekte të rëndësishme, duke veçuar kështu bashkëpunimin rreth deminimit të një lokacioni në parkun "Gërmia". Gjeneral Kastrati, gjithashtu, tha se FSK-ja dhe lidershipi i saj është jashtëzakonisht i interesuar që bashkëpunimi në mes FSK-së dhe FA të Suedisë të vazhdojë edhe më tutje.

Nga ana tij, gjeneral brigade Stefan Andersson, komandant i Komponentit Tokësore pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Suedisë, u shpreh se bashkëpunimi dhe miqësia ndërmjet FSK-së dhe FA të Suedisë është në nivelin më të lartë, dhe kjo është arritur falë kontakteve dhe projekteve të përbashkëta të dy institucioneve të të dyja shteteve, Suedisë dhe Kosovës. Gjenerali Andersson, shprehu gatishmërinë që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe më tutje.



Në takimin e përbashkët morën pjesë edhe zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral major Rrahman Rama dhe shefi i Departamentit për Bashkëpunim e Siguri, nënkolonel Hasan Hoxha.

MFSK dhe Forcat e Armatosura të Turqisë nënshkruan Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë

Në spitalet ushtarake të Turqisë do të trajtohen falas 50 pacientë, pjesëtarë të MFSK-së dhe FSK-së. Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, dr. Shkëlzen Sylaj, së bashku me një delegacion të Ministrisë qëndroi për një vizitë pune, treditore në Republikën e Turqisë. Qëllimi i vizitës ishte nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit-Protokollit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për trajnim dhe bashkëpunim në fushën e shëndetësisë ushtarake.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës marrëveshjen e nënshkroi sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, dr Shkëlzen Sylaj, ndërsa në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë, shefi i Logjistikës i Shtabit



të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjenerallejtënant Atilla Gülan.

Marrëveshja për bashkëpunim në mes të MFSK-së dhe Forcave të Armatosura të Turqisë, në fushën e shëndetësisë ushtarake parasheh bashkëpunimin në këto fusha: Trajnimi universitar i mjekësisë ushtarake, arsimimi i lartë i mjekësisë profesionale për nënoficerë, arsimimi i lartë i infermierisë, trajnim në fushën e stomatologjisë dhe në fushën e farmacisë, trajnimi para fillimit të misionit, kurset lidhur me misionin dhe trajnimi në vendin e punës, aktivitetet shkencore si: panelet, kongreset, seminaret, simpoziumet etj.

Gjithashtu në tekstin e Marrëveshjes janë të precizuara edhe fushat tjera, si: Trajtimi shëndetësor falas i 50 pacientëve, pjesëtarë të MFSK-së brenda vitit në spitalet ushtarake të Turqisë si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta trajnimi për studentë të diplomuar dhe ushtarakë për studime pasuniversitare në fushën e mjekësisë, shkëmbimin e instruktorëve, këshilltarëve, vëzhguesve, personelit të specializuar, stafit akademik dhe studenteve, trajtimi i pacienteve, bashkëpunimi në fushën e logjistikës mjekësore, vizitat në njësi, shtabe, spitalet ushtarake dhe institucionet tjera, organizimi i stërvitjeve të përbashkëta dhe dërgimi i vëzhguesve në stërvitjet e organizuara si dhe shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit dhe asistencës në fushën e krijimit të institucionit ushtarak shëndetësor, funksionimin e tyre dhe afrimin e shërbimit shëndetësor.

Kjo vizitë u realizua në kuadër të thellimit të bashkëpunimit në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë edhe në fushën e shëndetësisë ushtarake.

Kadetët e FSK-së treguan shkathtësi të jashtëzakonshme në ushtrimin fushor "Kampi i avancuar fushor 2014"





Ministri i FSK-së Agim Çeku i shoqëruar nga komandanti i Komandë së Forcave Tokësore (KFT-së) gjeneral major Rrahman Rama dhe komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS-së), gjeneral brigade Enver Cikaqi, më 23.05.2014, vizituan aktivitetet e 33 pjesëtarëve të FSK-së në ushtrimin fushor "Kampi i avancuar fushor 2014" që po mbahet prej datës 16-25 maj 2014, të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare (QSU), të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), në fshatin Zhegoc të Komunës së Gjilanit.

Fillimisht gjatë kësaj vizite para të pranishmeve foli komandanti i QSU-së kapiten Avni Kiçina i cili ua tregoi planin e detajuar të ushtrimit fushor "Kampi i avancuar fushor 2014" krerëve të lartë të FSK-së, si dhe detyrat dhe fazat e operacionit të mbajtur në Zhegoc të Gjilanit, duke përmendur planifikimin dhe përgatitjen, dislokimin, realizimin e operacioneve, konsolidimin dhe ri-dislokimin në QSU.

Sipas kapiten Kiçinës qëllimi i këtij ushtrimi ka qenë përmbledhja e aktiviteteve trajnuese në shkencat ushtarake dhe lidership, si dhe vlerësimi i njohurive të fituara gjatë vitit akademik 2013/ 2014. "Jam shumë i kënaqur me motivimin dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të kadetëve të QSU-së që kanë treguar në këtë kamp, duke i përfshirë të gjitha gjeneratat" u shpreh komandanti i QSU-së.

Para kadetëve të FSK-së foli edhe ministri i MFSK-së, Agim Çeku, i cili tha se Akademia Ushtarake e Kosovës është njëra nga tregimet më të suksesshme dhe kjo po dëshmohet edhe me rezultatet e kadetëve në këtë ushtrim. "Jam këtu që ta vizitojë kampin e akademisë ushtarake, kadetët e së cilës janë duke ushtruar skenarë të ndryshëm që në çdo situatë t'i marrin detyrat konkrete. Mburremi me akademinë ushtarake dhe me oficerët tanë të cilët janë të kompletuar si në aspektin e shkollimit civil edhe atë ushtarak", përfundoi ministri Çeku.

Një eksperiencë shumë e mirë ishte edhe për kadetin e vitit të katërt të QSU-së Ismail Hoxha. "Jemi në ditën e 7-të të ushtrimit fushor dhe kjo që po bëjmë ne është një eksperiencë e mirë, sepse ne i praktikojmë të gjitha aftësitë dhe njohuritë tona ushtarake qe i kemi mësuar në akademi. Çdo gjë këtu është më e vështirë se në qendër universitare, por ky vend këtu është sikur bota jonë me të cilën jemi mësuar të jetojmë" u shpreh kadet Hoxha.

Ushtrimi fushor "Kampi i avancuar fushor 2014" i kadetëve të FSK-së do të përfundojë më 25 maj 2014.

Pjesëmarrës në këtë ushtrim ishin: ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT-së), gjeneralmajor Rrahman Rama, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS-së), gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i QSU-së kapiten Avni Kiçina, përfaqësues të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s, si dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Gjeneral Brahimaj priti atasheun ushtarak të Turqisë

Komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Istog, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, me bashkëpunëtorë, priti në një takim pune atasheun ushtarak të Turqisë të akredituar në Republikën e Kosovës, kolonelin Hasan Aydogdu.

Me këtë rast, komandanti i BRSH-së, gjeneral Brahimaj i uroj mirëseardhje kolonelit Avdogdu dhe e njoftoi atë, me aktivitetet e përgjithshme që po zhvillon BRSH-ja, e sidomos u ndal me shumë në trajnimet e mbajtura me Ekipet Mobile Trajnuese Turke -EMTT. Në fund, gjeneral Brahimaj e falënderoi atasheun dhe Ekipet Turke, për kontributin e dhënë në trajnimin dhe në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të BRSH-së.

Koloneli Hasan Aydogdu, më pastaj, vizitoi edhe Batalionin e Dytë të BRSH-së, ku nga nënkolonel Mehmet Lladrovci, komandant i këtij batalioni u njoftua përmes një prezantimi të detajuar për misionin e Batalionit të Dytë, për strukturën, trajnimet, aktivitetet, operacionet dhe për bashkëpunimin me Ekipet Mobile Trajnuese Turke (EMTT).

Koloneli Avdogdu, atashe ushtarak i Republikës së Turqisë në Republikën e Kosovës, premtoi angazhim për bashkëpunim dhe ndihmë profesionale edhe në të ardhmen për FSK-në.



Certifikohen pjesëtarë të FSK-së, për Reagim të Shpejtë në Istog

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të FSK-së, në Istog, më 5 maj 2014, u mbajt ceremonia e certifikimit të 27 pjesëtarëve të Kompanisë 2B, të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), pas një trajnimi tre mujor (21 janar 15 prill 2014), mbajtur nga Ekipet Trajnuese Turke (ETT), i cili trajnim është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në mes Forcave të Armatosura të Turqisë dhe FSK-së.



Shefi i Shtabit të BRSH-së, nënkolonel Jeton Dreshaj, me këtë rast, falënderoi Ekipet Trajnuese Turke, për kontributin që këto ekipe kanë dhënë dhe po japin në ngritjen dhe profesionalizimin e pjesëtareve të BRSH-së, ndërsa nga pjesëtarët e certifikuar, kërkoi që njohuritë dhe shkathtësitë e fituara t'i bartin me sukses tek njësitet e tyre.

Ndërsa, koloneli Erdal Dodurga (këshillat i Komandantit të FSK), foli për rëndësinë dhe peshën që trajnimet e tilla kanë në zhvillimin dhe në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Ai, njëherësh, çmoi lart bashkëpunimin e mirë në mes Forcave të Armatosura të Turqisë dhe FSK-së dhe shprehu gatishmërinë për mbështetjen e FSK-së, në forma të ndryshme edhe në të ardhmen.

Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë: komandanti i BRSH-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, kolonel Erdal Dodurga (këshilltar i KOMFSK), kolonel Xhevahir Geci zëvendëskomandant i BRSH-së, nënkolonel Jeton Dreshaj, shef i Shtabit të BRSH-së, komandanti i Batalionit të Dytë, nënkolonel Mehmet Lladrovci dhe instruktorët e Ekipet Trajnues Turk.

Gjeneral Kastrati priti një grup studentësh nga Miçigani i SHBA-s

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 12 maj 2014, priti në Ministri një grup studentësh të viteve II, III dhe IV, të Universitetit të Miçiganit "Grand Rapids-Kornerstone", nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës(ShBA). Grupi i studentëve kryesohej nga Erik Bensen, profesor i historisë së çështjeve botërore.

Në fillim gjeneral Kastrati u shpreh i lumtur që FSK-ja është institucion i cili ka nxitur kureshtjen edhe të studiuesve të rijnë, nga një vend mik, siç është ShBA-ja. Gjeneral



Kastrati duke iu drejtuar grupit të studentëve tha se ne si institucion jemi në partneritet me Gardën Kombëtare të Aiovës (AIOWA), duke cekur një varg aktivitetesh të realizuara së bashku me oficerët dhe nënoficerët nga Aiova. Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati u fokusua në shtjellimin e rrugëtimit të FSK-së që nga vitit 2009 e deri më tani kur edhe ka përfunduar procesi i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Gjeneral Kastrati i njoftoj studentët amerikanë me misionin, strukturën detyrat dhe kapacitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pastaj edhe për përbërjen etnike dhe gjinore të pjesëtarëve të FSK-së. Gjithashtu, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati foli edhe për përkrahjen e FSK-së nga populli i Kosovës, bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar të FSK-së, si dhe angazhimin e FSK-së në operacione dhe trajnime të përbashkëta në regjion e më gjerë.

Bashkëbisedimi me komandantin e FSK-së, gjeneral Kastratin, bëri që studentët të shtrojnë një varg pyetjesh, kryesisht rreth të ardhmes së FSK-së.

Më tutje rreth Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë foli zonja Besa Kabashi Ramaj, këshilltare për politikë e ministrit Agim Çeku. Ajo tha se Republika e Kosovës e ka kryer me sukses procesin e RSSS-së dhe se ka identifikuar saktësisht nevojat e saj lidhur me sigurinë e vendit.

FSK përuroi urën mobile në fshatin Krushevë të Klinës

Ceremonia e përurimit të urës metalike në fshatin Krushevë të Vogël, solemnisht u bë më16 maj. Në këtë ceremoni morën pjesë: ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KF'T-së, gjeneral major Rrahman Rama, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Ilaz Dërguti, komandant i Brigadës Mbështetëse Operacionale (BMO), shefi i Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës të NATO-s (NLAT), gjeneral brigade Udo Schnittker, kryetari i Komunës së Klinës, Sokol Bashota, oficerë të lartë të FSK-së, si dhe qytetarë të fshatit.

Ura mobile e montuar nga Skuadra e urave të FSK-së, mbi lumin Drini i Bardhë, në fshatin Krushevë e Vogël, është e gjatë 33 metra dhe e gjerë 4 metra e gjysmë, e cila mbanë peshë deri në 20 tonë dhe është në shërbim të banorëve të fshatit Krushevë dhe fshatrave përreth.

"Skuadra e urave e Batalionit të Xhenios të Brigadës Mbështetëse Operacionale të FSK-së, ngritjen e urës e ka filluar më 22 prill dhe e ka përfunduar më 16 maj, e kanë kryer 9 ditë para afatit të paraparë. Kjo është ura e dytë e kësaj madhësie që pjesëtarët e FSK-së po e ngritin pas asaj në Kramovikë të Gjakovës", tha përgjegjësi i skuadrës së urave, oficeri Ismail Tahiri.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, me këtë rast i ka përgëzuar pjesëtarët e FSK-së, të cilët e kanë bërë një punë të mirë me ndërtimin e kësaj ure e cila do të jetë në shërbim të qytetarëve të kësaj ane.

"FSK-ja ka bërë një punë të mirë, këtë e dëshmuan edhe folësit para meje, se sa është kjo urë më rëndësi për ta. Për këtë jemi këtu sot, me bashkëpunëtorët e mi, për përurimin e këtij projekti që është në vazhdën e projekteve të shumta që po realizon FSK-ja, për t'u dalë në ndihmë komuniteteve dhe qytetarëve të Kosovës. Të gjitha projektet që i ka realizuar FSK-ja, si dhe më parë TMK-ja, janë në shërbim të gjithë qytetarëve të këtij vendi. FSK-ja ka ndërtuar shumë ura të cilat janë simbole që lidhin dy anët e lumit, por edhe që e lidhin FSK-në me qytetarët. Edhe kjo urë po dëshmon se ushtarët e Kosovës janë në shërbim të qytetarëve. Kjo urë është gjithashtu dëshmi se FSK-ja është në shërbim të lehtësimit dhe të mbrojtjes së tyre, por edhe për t'ua lehtësuar dhe përmirësuar kushtet. Ky projekt për neve është shumë me rëndësi sepse është në shërbim të qytetarëve dhe kjo po dëshmon aftësitë profesionale të FSK-së. Nuk ka qenë projekt i lehtë, por djemtë dhe vajzat e FSK-së, janë të përgatitur për realizimin e projekteve të tilla. Këtë projekt e kanë kryer para afatit të përcaktuar dhe kjo dëshmon për aftësitë profesionale të FSK-së".



Në fund, ministri Agim Çeku premtoi: "Projekte të tilla do të ketë edhe në të ardhmen, kudo që kanë nevojë qytetarët tanë. Nuk ka detyrë që nuk mund ta kryejmë, dhe që është në shërbim të qytetarëve të Kosovës", shtoi në fund ministri i MFSK-së, Agim Çeku.

Ndërsa, në emër të fshatit të pranishmit i përshëndeti prof. Dodë Prenaj, i cili, fillimisht, falënderoi FSK-në, ministrin Çeku dhe komandantin e FSK-së, gjeneral Kastratin. Më pas ai foli edhe për rëndësinë që ka kjo urë për 85 familje të këtij fshati si dhe për banorët e fshatrave përreth.

Prerjen e shiritit në mënyrë simbolike e bënë: ministri i MFSK-së, Agim Çeku, kryetari i Komunës së Klinës Sokol Bashota, kryetari i fshatit Llesh Skelaj dhe shefi i Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës të NATO-s (NLAT), gjeneral brigade Udo Schnittker.

Bashkëpunim i mirë në mes FSK-së dhe Forcave Amerikane për Evropë

Rreshter majori i Komandës së Forcave Amerikane për Evropë, David Davenport, me bashkëpunëtorë, më 13 maj 2014, zhvilloi një vizitë pune në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me qëllim koordinimi rreth thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit në mes të Ushtrisë Amerikane, Komandës në Evropë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Vizita u realizua në ambientet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, ku fillimisht u prit nga Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi si dhe nënoficerë të lartë të FSK-së, kryesuar nga rreshter majori i FSK-së, Genc Metaj.

Rreshter major David Davenport gjatë gjithë kohës shoqërohej edhe nga rreshter majori Allen Dahl, nga Zyra e Bashkëpunimit për Mbrojtje pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës(ShBA) në Prishtinë.

Qëllimi i takimit ishte thellimi i bashkëpunimit në mes të Forcave Amerikane për Evropë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në zhvillimin dhe avancimin e mëtutjeshëm të trupës së nënoficerëve. Forcat Amerikane për Evropë janë bashkëpunëtorët kryesorë në zhvillimin e kurseve institucionale për nënoficerë. Deri më tani, mbi 120 nënoficerë të FSK-së, kanë kryer trajnime në Akademinë e Nënoficerëve në Grafenwoerh të Republikës Federale të Gjermanisë dhe në qendrat tjera të trajnimeve.

Seminar për implementimin e Planit të Veprimit të Qeverisë për zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria"

Njësia për të Drejta të Njeriut në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK) dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komandën e Forcave Tokësore(KFT), më 8 maj 2014, kanë mbajtur seminar për Anëtarët e Rrjetit për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore nëpër Njësitë e FSK-së. Seminari kishte për qëllim njoftimin me Rezolutën 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria" të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara(KSOKB) dhe detyrat që dalin nga Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj rezolute i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (29 janar 2014).





Halime Morina-Lupçi, shefe e Njësisë për të Drejtat e Njeriut në MFSK, i njoftoi të pranishmit për Rezolutën 1325 " Gratë Paqja dhe Siguria" të KS të OKB-së dhe detyrat që dalin nga Plani i Veprimit. Zonja Morina, ndër të tjera tha: Pjesëmarrja e femrave në Institucionet e Sigurisë është, në radhë të parë, çështje e të drejtave të njeriut, që e prek të drejtën e femrave për profesionin e ushtarakut. Ajo shtoi gjithashtu, se pozicioni i grave sot nuk është thjesht një koncept sasior, por nënkupton kufijtë e nevojshëm të përfshirjes së grave në proceset e shtet ndërtimit. Nëse femrat përjashtohen nga pjesëmarrja në institucione të tilla të rëndësishme, siç janë institucionet e sigurisë, respektivisht Forca e Sigurisë së Kosovës, ato vendosen në pozitë të pabarabartë, theksoi Halime Morina-Lupçi.

Para anëtarëve të rrjetit të FSK-së znj. Morina-Lupçi, prezantoi publikimin e Broshurës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore,duke numëruar një varg të arriturash në promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në MFSK dhe FSK.

Hadije Binaku, Zyrtare për Barazi Gjinore në KFT, diskutoi për aktivitetet konkrete që do të ndërmerren në FSK, në kuadër të realizimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, si dhe kërkoi veprim aktiv për implementim të rekomandimeve.


Ndërsa për perspektivën gjinore sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar foli Krenare Sogojeva - Dermaku, drejtore e Departamentit Ligjor në MFSK. Znj. Dermaku, ndër të tjera theksoi: Korniza ligjore e Republikës së Kosovës garanton të drejta të barabarta për të gjithë pa dallim dhe të gjithë pjesëtarëve të FSK-së u ofrohet trajtim pa dallim gjinie e etnie, çmohen dhe të respektohen si individë dhe mbështeten e shpërblehen sipas rregullave dhe kushteve proporcionale të shërbimit. Të gjitha normat ligjore, janë në harmoni të plotë me standardet e NATO-s. Po ashtu theksoi se në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës ekziston dhe vepron Ekipi Këshillues i NATO-s, i cili këshillon të gjitha departamentet në profilet përkatëse.

Anëtarët e Rrjetit për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore nëpër Njësitë e FSK-së, pjesëmarrëse në seminar, shfaqën interesim dhe diskutuan mbi aktivitete konkrete nëpër njësi që do të afirmonin angazhimet që dalin nga Rezoluta 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria" të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSOKB).

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 25 • Korrik 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku priti drejtorin për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë, Steve McCarthyn



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku, më 5 qershor 2014, priti në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), drejtorin për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes të Britanisë së Madhe Steve McCarthy të shoqëruar nga ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë Ian Cliff, këshilltari i komandantit të FSK-së nënkolonel David Jones dhe dy atashe ushtarak. Ministri Çeku informoi mysafirin për rezultatet e arritura, zhvillimin aktual të FSK dhe angazhimet për ngritje dhe profesionalizim e saj të mëtejmë në përputhje edhe me rekomandimet e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës (RSSSK). Nga ana e tij drejtori McCarthy shprehu gatishmërinë për vazhdimin e përkrahjes së Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar për FSK-në, sidomos në zhvillimin e bashkëpunimit me NATO-n drejt ngritjes së partneritetit formal. Në takim morën pjesë sekretari i përgjithshëm i MFSK-së Shkëlzen Sylaj, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe drejtori i ekipit këshillues të NATO-s në MFSK Kevin Lynch.

Ministri Çeku priti komandantin e ardhshëm të KFOR-it, gjeneralmajor Franqesko Paolo Figliuolo



Ministri i FSK-së, Agim Çeku i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj dhe të gjithë gjeneralët e FSK-së, të kryesuar nga Komandanti i Komandës së Forcës Tokësore (KFT-së) gjeneralmajor Rrahman Rama, më 24 qershor 2014, pritën në një vizitë njohje komandantin e ardhshëm të KFOR-it (që do të emërohet nga shtatori i këtij viti) gjeneralmajor Franqesko Paolo Figliuolo i cili shoqërohej nga një delegacion i oficerëve të lartë të KFOR -it.
Në fillim ministri Çeku e njoftoi gjeneralin nga Italia me zhvillimet e deritashme në FSK, perspektivën dhe rekomandimet që kanë dalë nga Rishikimi i Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës (RSSSK). Si objektiv të radhës dhe të një rëndësie të veçantë ministri Çeku theksoi transformimi e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës dhe atë të MFSK-së në Ministri të Mbrojtjes. Ai me këtë rast vlerësoi lartë kontributin e KFOR-it në ndihmën që i ka dhënë FSK-së në arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale, duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen.
Nga ana e tij gjeneralmajor Franqesko Paolo Figliuolo shprehu gatishmërinë për të vazhduar këtë bashkëpunim të ngushtë që ekziston mes FSK-së dhe KFOR-it edhe gjatë mandatit të tij, në të ardhmen, në të gjitha fushat e mundshme.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati mori pjesë në Konferencën Karta e Adriatikut-SHBA



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral-major Timoty Orr, morën pjesë në punimet e Konferencës së 18-të Karta e Adriatikut A5 në Budvë, Mal të Zi, e cila përfundoi punimet më 12 qershor 2014, me nënshkrimin e një deklarate të përbashkët të vendeve anëtare të Kartës së Adriatikut-SHBA. Gjeneral Kastrati gjatë punimeve të Konferencës pati takime të shumta bilaterale me të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës dhe me përfaqësuesit e EUCOM-it, Vice Admiralin Charles W. Martoglio, KunderAdmiralin Patric Piercey. Vice Admirali Martoglio ka vlerësuar lartë punën e deritanishme të FSK-së, si dhe shprehu gatishmërinë për të vazhduar mbështetjen e FSK-së, edhe në të ardhmen. Tema bosht e Konferencës ishte "Mirëmbajtja e Interoperabilitetit Përmes Partneritetit Regjional" por u diskutuan edhe çështjet rreth rritjes se interoperabilitetit, përgatitja dhe mirëmbajtja e forcave për reagim në rast të krizave dhe emergjencave, mbrojtja e përbashkët ajrore, intensifikimi i trajnimeve dhe shkollimeve të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura nëpër vendet e rajonit, nënshkrimi i marrëveshjeve teknike për mbështetje më të shpejtë të vendeve në rast emergjencash, organizimi i ushtrimeve të përbashkëta ku do të involvohen edhe partneret nga Garda Kombëtare e SHBA-s.
Në këtë konferencë, morën pjesë shefat e Mbrojtjes të pesë vendeve nënshkruese të Kartës së Adriatikut-SHBA: Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, përfaqësues nga Komanda Amerikane për Evropë (EUCOM), zëvendës shefi i Mbrojtjes së Sllovenisë dhe komandantët e Gardave Kombëtare partnere me vendet e rajonit, si: përfaqësuesi i Komandës Kryesore të Gardës Kombëtare të SHBA-s, Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajoves, Nju Xhersit, Kolorados, Minesotes, Vermontit si dhe Komandanti i KFOR-it.
Në fund, ministrja e Mbrojtjes së Malit të Zi, znj. Milica Pejanovic-Djurishiq organizoj një pritje të veçantë për të pranishmit, ku prezantoi edhe presidenti i Malit të Zi, z. Filip Vujanoviq.

Pas shpërthimit të bombolës së gazit në Termocentralin Kosova A

FSK arriti që ta nxirrte një person të gjallë nga vendi i shpërthimit



Pjesëtarë të Kërkim-Shpëtimit(KSH) të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK) kanë arritur që rreth orës 15 e 20 të datës 6 qershor 2014, të nxjerrin një person të gjallë nga vendi i fatkeqësisë me rastin e shpërthimit të bombolës së hidrogjenit në Repartin e Elektrolizës të Termocentralit "Kosova A", të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në Kastriot, si dhe vazhdon kërkimi për personat e tjerë. Në të njëjtën kohë Kompania e Mbrojtjes Kimike Atomike dhe Biologjike (MKAB), është duke vazhduar të vlerësojë situatën e rrezikut në vend incident.
Me vendim të ministrit të FSK, z. Agim Çeku dhe me urdhër të komandantit gjenerallejtënant Kadri Kastrati, sipas vendimit të Qendrës së Situatave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, ka shpallur gjendje gatishmërie dhe ka mobilizuar të gjithë efektivat për angazhim në operacion sipas shkallës së rrezikut.
Me urdhër të gjeneral Kastratit, Forca e Sigurisë së Kosovës(FSK) ka angazhuar njësitë operacionale të saj, pas fatkeqësisë me rastin e shpërthimit të bombolës së hidrogjenit, në Repartin e Elektrolizës të Termocentralit "Kosova A", të Korporatës Energjetike të Kosovës. Prej marrjes së urdhrit për angazhim e deri më tani, FSK ka angazhuar në operacion 65 pjesëtarë, prej tyre nga Kompania e Kërkim-Shpëtimit, Kompania e Mjekësisë, MKAB, Kompania Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave, Polica e FSK-së etj.

Vijon në faqen 4-5

Gjeneral Bazo priti të ngarkuarin me punë të Republikës së Kosovës në Tiranë, z. Veselaj dhe atasheun ushtarak të Kosovës, nënkolonel Enver Dugolli



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FASH), gjeneralmajor Jeronim Bazo, më 27 qershor 2014, priti në takim të veçantë të ngarkuarin me punë të Republikës së Kosovës në Tiranë, z. Gani Veselaj dhe atasheun ushtarak të sapo akredituar në Shqipëri, i pari atashe ushtarak i Republikës së Kosovës në Tiranë, nënkolonel Enver Dugolli.

Gjeneral Bazo pasi i uroi mirëseardhje, e siguroi atasheun ushtarak të Kosovës nënkolonel Enver Dugollin për mbështetjen e tij si shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për realizimin me sukses të detyrës së tij të rëndësishme. Gjithashtu, gjenerali Bazo, i premtoi nënkolonel Dugollit, se do ta ketë mbështetjen e plotë të tij, " Do të keni mbështetjen time si SHSHP të FARSH për realizimin me sukses të detyrës si edhe gatishmërinë dhe përpjekjet e FARSH për të asistuar Forcën e Sigurisë së Kosovës në drejtim të edukimit, trajnimit e stërvitjes, si dhe në drejtim të lobimit dhe integrimit euroatlantik". Gjeneral Bazo vlerësoi mbështetjen e aleatëve, në veçanti SHBA-s për mbështetjen e Kosovës dhe çështjes shqiptare e cila ka kulmuar me krijimin e shtetit të Kosovës dhe hyrjes së Shqipërisë në NATO, një mbështetje që po vazhdon edhe me integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike. Në këtë drejtim u vlerësua pjesëmarrja e gjenerallejtënant Kadri Kastrati në takimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të A5, që u zhvillua në Budvë, Mali i Zi, më datë: 10-12 qershor 2014. Gjeneralmajor Bazo, si bashkëdrejtues i kësaj konference mirëpriti pjesëmarrjen e Kosovës në këtë konferencë dhe theksoi nevojën e integrimit të saj edhe në iniciativat e tjera, gjë e cila do të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe frymës së bashkëpunimit në rajon e më gjerë. Në fund, z. Veselaj dhe nënkolonel Dugolli e falënderuan shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo për mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë në dy dekadat e fundit dhe gatishmërinë dhe angazhimin për ta çuar më tej këtë bashkëpunim.

Ambasadori Ian Cliff ligjëroi para oficerëve të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj

Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, z. Ian Cliff, më 12 qershor 2014, para oficerëve dhe nënoficerëve të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, ligjëroi në temën: "Marrëdhëniet Ndërkombëtare me Diplomaci". Ambasadorin Cliff, në ambientet e kazermës "Skënderbeu" e priti komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili fillimisht e falënderoi ambasadorin Cliff, për ndihmën e madhe që po jep Mbretëria e Bashkuar për FSK-në, dhe pastaj e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes si dhe me synimet për të ardhmen e KDS-së. Ambasadori Ian Cliff, me këtë rast, tha: "Ndjehem tejet i lumtur që po i shoh këto të arritura të KDS-së dhe përkushtimin tuaj ndaj punës", ndërsa, më pas ai mbajti ligjëratën me temë "Marrëdhëniet Ndërkombëtare me Diplomaci", me fokus misioni diplomatik dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes. Cliff, foli për sfidat e diplomacisë, rolin e saj në politikën e jashtme por edhe për misionet e tij, jashtë shteti, si ambasador i Britanisë së Madhe.

Një pjesë të ligjëratës, ai e fokusoi në çështjet e Kosovës, sfidat dhe të arriturat jo vetëm në diplomaci, por në të gjitha fushat, për të shtuar se: "Kosova ka shënuar progres në shumë fusha dhe ne po përpiqem ta ndihmojmë Kosovën". Në fund, ambasadori Ian Cliff, iu përgjigj shumë pyetjeve të pjesëtarëve të KDS-së, që kishin të bënin me zhvillimet në vend dhe themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), ligjërata me temë nga diplomacia, kanë mbajtur edhe ambasadorë të shteteve të tjera të akredituara në Kosovë.

FSK-ja për herë të parë në Konferencën e Historisë Ushtarake në Gjermani

Një delegacion i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), i prirë nga kolonel Skënder Zhitia, shef i Departamentit të Personelit, më 4 qershor 2014, mori pjesë në Konferencën e 55-të Ndërkombëtare të Historisë Ushtarake në Potsdam të Republikës Federale të Gjermanisë. Gjithashtu në këtë konferencë ishin të pranishëm atasheu i FSK-së në Gjermani, kolonel Xhavit Sadrija dhe toger Vegim Krelani. Konferenca ka zhvilluar punimet nga data 2 deri më 5 qershor 2014. Në Konferencën e 55-të Ndërkombëtare të Historisë Ushtarake u debatua për temat: "Dinamika e Globalizimit-Rajhu Gjerman ndërmjet konfliktit shtetëror Evropian dhe Lufta



Botërore 1914-1918".

Në këtë konferencë u trajtuan aspektet strategjike dhe historike të Luftës së Parë Botërore dhe ndikimet që kanë pasur ato në vitet pasuese. Pjesëmarrës të konferencës ishin përfaqësuesit e Instituteve të Historisë Ushtarake nga vende të ndryshme të botës.

Gjatë konferencës delegacioni i FSK-së pati disa takime me drejtues të Institutit të Historisë Ushtarake të Gjermanisë dhe të vendeve tjera. Është hera e parë që delegacioni i FSK-së mori pjesë në konferenca të kësaj natyre.

Marrëveshje bashkëpunimi në mes Ministrisë për FSK-në dhe Komunës së Prishtinës

Në ambientet e Komunës së Prishtinës, më 19 qershor 2014, u nënshkrua Marrëveshje Bashkëpunimi në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe Komunës së Prishtinës.

Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë: Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Sejdi Geci, shef i Sektorit të Planeve dhe Programeve të Departamentit të BCU-së në MFSK dhe major Arife Halili, shefe e Departamentit të BCU-së në Komandën e Forcave Tokësore (KFT). Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi në mes të dyja institucioneve, ku FSK-ja do të bëjë pastrimin dhe rehabilitimin e hapësirës në mes të lagjeve Arbëria dhe Kodra e Trimave në Prishtinë.

Komuna e Prishtinës do të asistojë dhe ndihmojë Forcën e Sigurisë së Kosovës gjatë trajtimit dhe pastrimit të hapësirës së identifikuar më lartë, do të bëjë hartimin e planit të parkut dhe planin e hedhjes së mbeturinave të trajtuara si dhe do të sigurojë fidanët për gjelbërimin e parkut.

Ndërsa, Forca e Sigurisë së Kosovës me makinerinë adekuate dhe personel do të angazhohet në realizimin e këtij projekti.

Marrëveshjen në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës e nënshkruan Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane në këtë Ministri dhe në emër të Komunës së Prishtinës, Xhelal Sveçla, drejtor i Inspektoratit të Komunës së Prishtinës.

Memorandum Mirëkuptimi në mes MFSK-së dhe Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë

Në ambientet e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, u nënshkrua Memorandum Mirëkuptimi në mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK) dhe Universitetit "Haxhi Zeka në Pejë, për dhënien në shfrytëzim të objektit të FSK-së, për studentët e këtij universiteti.

Në ceremoninë e nënshkrimit të Memorandumit, më 2 qershor 2014, mori pjesë edhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati si dhe profesorë dhe studentë të Universitetit "Haxhi Zeka". Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është dhënia dhe marrja në shfrytëzim e ish-objektit të FSK-së, i cili objekt gjendet në kazermën e FSK-së në Pejë, dhe është pronë nën menaxhimin dhe administrimin e FSK-së. Dhënia në shfrytëzim e objektit bëhet me qëllim të shfrytëzimit të hapësirës së këtij objekti për qëllime të zhvillimit të procesit mësimor nga personeli dhe studentët e Universitetit " Haxhi Zeka" në Pejë.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku, përveç tjerash, ua ka përkujtuar studentëve se qëllimi i tij dhe i Qeverisë së Kosovës për dhënien e këtij objekti në shfrytëzim është që t'u krijohet hapësirë e nevojshme studentëve të këtij universiteti. Ai ndër të tjera u shpreh: "Jam i bindur se përpjekjet tona do të shpërblehen me dije të reja nga ana e juaj në të gjitha fushat. Ne jemi duke u angazhuar që të krijojmë lehtësira të reja për të gjithë ju, andaj edhe ju duhet të angazhoheni maksimalisht që të pajiseni me sa më shumë dije, në mënyrë që ato t'i përdorni në shërbim të atdheut dhe kombit"- tha në fund ministri Çeku. Në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Memorandumin e Mirëkuptimit e nënshkroi ministri Agim Çeku, ndërsa për Universitetin "Haxhi Zeka" rektori, dr. Naser Mrasori. Me këtë rast u dha edhe një program artistik me këngë, ekzekutuar nga studentët e këtij universitetit.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

FSK-ja organizoi "Kampin Rinor 2014" për nxënësit e shkollave të mesme të Kosovës



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, më 13 qershor 2014 u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve në 'Kampin Rinor 2014' që ka filluar më 9. 06. 2014 deri më 13. 06. 2014, ku morën pjesë 37 nxënës të shkollave të mesme nga komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës, në mesin e tyre 13 femra.

Me këtë rast, komandanti i Qendrës së Stërvitjes Bazike (QSB), major Sami Hajrullau tregoi në mënyrë kronologjike ecurinë e këtij kampi duke potencuar se në këtë kamp ata janë njohur dhe familjarizuar me rendin ushtarak, historinë e FSK-së, strukturën dhe misionin si dhe shumë aktivitete të pjesëtarëve të FSK-së. "Nxënësit gjatë gjithë kohës kanë treguar sjellje, disiplinë dhe interesim të lartë për të mësuar sa më shumë nga lëmi i jetës ushtarake. Unë falënderoj nxënësit dhe instruktorët e QSB-së për kontributin e tyre që kanë dhënë në mbarëvajtjen e kampingut rinor, njëherësh nxënësve iu uroj shumë suksese në shkollim dhe jetën e tyre privatë" tha major Hajrullahu. Para të pranishmëve foli edhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në MFSK, Hajrush Kurtaj i cili tha: Për këtë ditë janë sakrifikuar shumë gjenerata që, ne, ta kemi uniformën tonë, uniformën e cila ndanë gjithçka me popullin si në rastin e juaj. Ka qenë një kënaqësi për gjithë neve, që në mesin tonë për këto ditë, keni qenë ju, rinia e Kosovës, e ardhmja e këtij vendi. Për 5 ditë qëndrimi në KDS, besoj që keni mësuar sadopak për FSK-në, jeni njohur me detyrat dhe misionin e saj si dhe m me të gjitha aktivitetet ditore të një ushtaraku"-tha në fund të fjalës së tij Kurtaj. Kurse pjesëmarrësit e këtij kampi rinor u shprehen me plot emocione për qëndrimin e tyre njëjavor në KDS, ku shumica prej tyre nuk ngurruan të shfaqin dëshirën e tyre që në të ardhmen të bëhen pjesë e FSK-së. Ilirjana Gashi nxënëse e shkollës së mesme teknike "Anton Cetta", në Skenderaj tha: "Ne, për një javë ishim pjesë e jetës ushtarake dhe u njohëm nga afër me këtë jetë e cila me pëlqen jashtëzakonisht shumë, dhe shpresoj që një ditë të bëhem pjesë e saj"-tha ndër të tjera ajo. Ndërsa, Endrit Sopa, nga shkolla e mesme "Skënder Luarasi"në Suharekë, duke shprehur falënderim për mikpritjen në FSK, ndër të tjera shtoi: "Ndihem i privilegjuar që kam qenë pjesë e këtij kampi dhe jam njohur më shumë njerëz. Në fillim me është dukur pak e vështirë jeta ushtarake, sidomos zgjimi herët në ora 6:30 dhe rregullimi i shtratit, por shpresoj se këto rregulla dhe kjo disiplinë do të më shërbejnë në të ardhmen" qeshë Sopa. Antigona Abdullahu nxënëse nga shkolla e mesme "Mehmet Isai" nga Gjilani, rreth qëndrimit në këtë kamp na tregoi me pak fjalë përshtypjet e saj "Të jesh pjesë e këtij kampi është më të vërtet sfidë e veçantë sepse këtu kemi pasur shumë aktivitete në intervale të caktuara. Ka shumë çka që unë do t'u tregojë shoqërisë sime. Në veçanti me ka lënë mbresa të jashtëzakonshme mirëpritja dhe puna e palodhshme e instruktorëve të FSK-së, që kanë bërë. "Asnjëherë s'jam ndjerë më krenar dhe më i fortë se sa ketë javë, që kam bartur uniformën e FSK-së" shprehet Adonis Deliu, nga shkolla "Xhelal Hajda-Toni" nga Rahoveci. E Marigona Jetullahu nga Gjilani, porositë të rinjtë: "Ta duan profesionin e ushtarakut se është profesion qe të bënë të ndihesh krenar "Kampi Rinor 2014" është realizuar për herë të parë në ambientet e shkollës së QSB-së, të KDS-së në Ferizaj, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e KDS-së dhe me mbështetje të Departamentit për Marrëdhënieve Civilo-Ushtarake të Ministrisë së FSK-së dhe Komandës së Forcave Tokësore (KFT). Në ceremoni morën pjesë: zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, komandanti i QSB-së, Sami Hajrullahu, drejtori i BCU-së, në MFSK-së, z. Hajrush Kurtaj, oficerë të KDS-së si dhe instruktorët të cilët kanë punuar më këta nxënës.





FSK-ja ndërtoi rrugën në fshatin Zebincë të Artanës

Projektin e ndërtimit të rrugës në gjatësi prej 1. 9 km në fshatin Zebincë të Artanës e kanë realizuar pjesëtarë të Batalionit të Xhenios të FSK-së, ndërsa financimin e kanë bërë Ambasada e Britanisë së Madhe dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe është zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM).

Ceremonia e inaugurimit të rrugës u bë më 12 qershor 2014, në fshatin Zebincë të Artanës, ku morën pjesë: zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Muhamet Latifi, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i KFOR-it, gjenerali Selvatore Farina, shefi i Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës të NATO-s (NLAT), gjeneral brigade Udo Schnittker, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, z. Ian Cliff, zëvendës shefi për bashkëpunim, Zyra e BE-së, në Kosovës, z. Mevlin Asin, kryetari i Komunës së Artanës z. Svetislav Ivanoviq, ministri i Ministrisë për Kthim të Komuniteteve, z. Dalibor Jeftiq, përfaqësues të IOM-it, komandanti i Batalionit të Xhenios, nënkolonel Zejnullah Prokshi, oficerë të KFOR-it dhe të FSK-së, banorë të fshatit, qytetarë dhe mysafirë të shumtë. Ky projekt është realizuar në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të MFSK me Komunën e Artanës, dhe është i një rëndësie të veçantë, pasi që ka bërë të mundur lidhjen e fshatrave të kësaj ane me qendrën komunale. Pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të FSK-së, kanë bërë zgjerimin e rrugës, hapjen e kanaleve, vendosjen e urave si dhe shtrimin me zhavorr. Me rastin e përurimit të rrugës, zëvendësministri i MFSK-së, z. Muhamet Latifi, fillimisht ka falënderuar pjesëtarët e Batalionit të Xhenios, për punën e madhe që kanë bërë edhe po bëjnë në realizimin e projekteve të tilla, për të shtuar se: "FSK-ja deri më tani ka kryer qindra projekte humanitare në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, në të gjitha pjesët e saj, pa dallime etnike dhe fetare". Ai premtoi se edhe në të ardhmen do të vazhdojë realizimin e projekteve të këtilla, kudo, që kanë nevojë qytetarët e Kosovës. Kryetari i Artanës Svetislav Ivanoviq, ka thënë se ky projekt ka një rëndësi të veçantë sepse u ndihmon të gjithë qytetarëve të kësaj ane për të pasur qasje më të lehtë me qendrën komunale, për të shtuar, se: "Kjo rrugë më parë ka qenë e pakalueshme". Në emër të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete të Qeverisë së Kosovës ka falënderuar FSK-në, ministri Dalibor Jeftiq, ndërsa, në emër të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, ka përshëndetur ambasadori Ian Cliff, i cili ka falënderuar FSK-në për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm për banorët e kësaj ane dhe në emër të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë ka folur zëvendës shefi për bashkëpunim, z. Melvin Asin.

Për angazhimin dhe punën e kryer në realizimin e këtij projekti, të pranishmit i njoftoi shef i Shtabit të Batalionit të Xhenios, major Ilmi Ramusholli. Në fund, prerjen e shirit solemnisht e bënë zëvendës komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli së bashku me një banore të fshatit Zebincë.

Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së priti në vizitë përfaqësuesen e Institutit për Paqe të SHBA-ve

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 27 qershor 2014, qëndroi për vizitë zyrtare znj Ariana Barth, asistente e programit Academy for Conflict Mangement and Peacebuilding". Znj Barth u takua me sekretarin e përgjithshëm të MFSK-së, z. Shkelzen Sylaj.

Instituti për Paqe i SHBA-ve, është institut i pavarur, jo partiak, i krijuar nga Kongresi Amerikan i cili kryesisht merret me analizë dhe përkrah zonat pas konflikteve.

Ky institut, trajnon dhe përgatit këshilltarët e lartë të cilët dërgohen për misione anë e kënd botës. I trajnuar nga ky institut që nga gushti i vitit të kaluar, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, punon në cilësinë e këshilltarit z. Al Kulynych i cili punon ngushtë në baza ditore, me udhëheqësit e lartë të Ministrisë, duke dhënë këshilla mbi procese të rëndësishme për institucionin.

Në këtë takim u znj. Barth u njoftua për zhvillimin e Ministrisë dhe të FSK-së, për projektet e tanishme, procesin e RSSS-së dhe produktet e saja, planet dhe prioritetet e institucionit të sigurisë si dhe për transformimin e Forcës së Sigurisë në Forcat e Armatosura, si dhe planin afatgjatë të zhvillimit. Znj. Barth, përgëzoi MFSK-në për punën, seriozitetin, përkushtimin, transparencën dhe besueshmërinë që ka ky institucion në Kosovë sipas sondazhit të fundit, si dhe për progresin që shteti i Kosovës ka bërë në këto vite.



Pas intervenimit të FSK-së në Termocentralin "Kosova A"

FSK-ja tregoi profesionalizëm të lartë gjatë intervenimit në Korporatën Energjetike të Kosovës

Nënkolonel Agron Bajrami, komandant i incidentit "FSK-ja me intervenimin në Termocentralin "Kosova A" ka dhënë shembullin më të mirë të një institucioni të organizuar, efikas, të disiplinuar dhe me moral të lartë ushtarak"



Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) gjatë intervenimit të njësive të saj, pas shpërthimit të një bombole me hidrogjen në Termocentralin "Kosova A" në Obiliq, më datën 06 qershor 2014, sipas komandantit të incidentit nënkolonel Agron Bajrami, shefi i Shtabit të BMO-së, ka treguar profesionalizëm të lartë me të gjitha njësitë e saj pjesëmarrëse. Duke filluar nga aspektet e koordinimit të veprimeve fillestare të ekipit të Njësisë Ndërlidhëse për Reagimin në Kriza (NJNRK-së) me institucionet pjesë e operacionit duke lavdëruar punën, angazhimin dhe profesionalizmin e FSK-së.

Nënkolonel Bajrami përmend edhe shkallën e rrezikshmërisë në operacione reale, vendin ku ka ndodhur incidenti si dhe menaxhimin e tij nga udhëheqësit dhe përgjegjësit e incidenteve. "Në këtë operacion fillimisht rreziku ka qenë i lartë, por me veprimet e ndërmarra për detektimin dhe vlerësimin e zonës nga njësia e MKAB-së e cila ka bërë një punë profesionale ne kemi ardhur në





tjera, sigurimin e perimetrit të zonës së operacionit nga Policia e FSK-së, mbështetja mjekësore nga Kompania e Mjekësisë, Kompania e Komunikimit dhe mbështetja nga Batalioni i Logjistikës, ekipet profesionale të Task-Forcës dhe Mbrojtja Kimike Atomike Biologjike (MKAB-së) e deri tek stafi tjetër i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK-së), Komandës së Forcave Tokësore (KFT-së) dhe Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO-së), kanë qenë profesional në ekzekutimin e detyrave gjatë gjithë kohës së operacionit. Dhe sipas tij ky ka qenë vlerësim edhe i aktorëve tjerë që kanë qenë përfundim se nuk ka rrezik të shkallës i cili nuk mund të menaxhohet. Edhe pse fillimisht vlerësimet kanë qenë shqetësuese për ndonjë shpërthim tjetër të mundshëm, kjo ka ndikuar që ne të planifikojmë me kujdes fillimin e operacioneve të KSH duke marrë për bazë sigurinë e forcave tona në terren. Rreshteri i MKAB-së Bajram Peci tregon momentet e para të hyrjes se pjesëtarëve të MKAB-së në zonën e rrezikshme. Pjesëtarët e MKAB-së (rreshter Bajram Peci dhe ushtar Besnik Çitaku) janë të parët që kanë hyrë në vendin ku ka ndodhur shpërthimi dhe së bashku më ekipin e Policisë, gjegjësisht Njësinë e Bombave dhe dy pjesëtarë të KEK-ut kanë inspektuar për rrezikshmërinë që mund t'u kanoset pjesëtarëve apo popullatës. Pas një inspektimi afër 15-20 minutave ekipi kthehet në vendin e grumbullimit për të raportuar për gjendjen në vend incident dhe vijnë në përfundim që s'ka rrezik të lartë të shpërthimit të ndonjë materie kimike brenda, që do të dëmtonte në shkallë të lartë. Vërtetimi për kalimin e këtij rreziku u bë pas inspektimit të dytë të pjesëtarëve të MKAB-së të të gjitha bombolave të ndodhura aty. Rreshteri i MKAB-së thotë se: "Qëllimi i vetëm në ato momente ka qenë shpëtimi i jetës së ndonjë personi të gjendur nën gërmadha dhe të jem i sinqertë në ato momente as që më është kujtuar jeta ime"

Për oficerët apo edhe nënoficerët që kanë të bëjnë me vlerësimin e rrezikut është mjaft sfidë aspekti i sigurisë së trupave për shkak të papriturave që mund të ndodhin gjatë një operacioni, por nga përvoja qe kemi, FSK ka aftësi dhe shkathtësi për të menaxhuar rrezikun në operacione të tilla, "rreziku duhet të kalkulohet e jo të anashkalohet"- thotë komandanti i incidentit nënkolonel Agron Bajrami.

Misioni i suksesshëm Task Forcës Kërkim-Shpëtimit të FSK-së

Ai po ashtu thekson se gjatë këtij operacioni të gjitha njësitë e FSK-së kanë treguar gatishmëri të plotë për të reaguar dhe shpëtuar jetën e punëtorëve të KEK-ut. Përveç gatishmërisë, personeli i forcës ka treguar guxim dhe punë vetëmohuese për të realizuar misionin e tyre dhe kjo është vërtetuar në fillimin e operacionit kur shkalla e rrezikut ka qenë e lartë dhe personeli i Task-Forcës e ka nxjerrë viktimën e parë nga objekti i rrënuar. Duke marrë parasysh kryerjen e shumë trajnimeve praktike të pjesëtarëve të kërkim-shpëtimit dhe suksesin e treguar në këto trajnime, një gjë të tillë ata e kanë treguar edhe gjatë operacionit real në Obiliq, ku pavarësisht rrezikut ata kanë kryer punën e tyre sipas procedurave dhe standardeve të kërkuara. Sipas liderit të skuadrës së Kërkim Shpëtimit Urban të Task Forcës, rreshter Mexhid Trollit, gjatë disa orëve punë të pandërprerë, pjesëtarët kanë treguar nivel të lartë të profesionalizmit dhe pavarësisht vështirësive në punë për nxjerrjen e kufomave nga gërmadhat, ata për asnjë moment nuk kanë ndjerë lodhje e shqetësim, përkundrazi në momentin kur kuptuan që nën gërmadha gjenden një person i gjallë atyre iu shtua edhe më shumë vullneti për punë dhe përkushtim.

"Gjatë hulumtimit nën gërmadha emocioni më i madh ka qenë kur, duke u bazuar në profesionalizmin tonë si dhe instinktin personal, kam kuptuar që nën gërmadha gjendet një person i gjallë. Këtë e kam kuptuar kur kam dëgjuar frymëmarrjen e tij me vështirësi dhe për t'u vërtetuar kam kërkuar edhe mendimin e kolegut tim rresht Valdrin Kelmendit nëse edhe ai mendon që ka person të gjallë aty. Pasi edhe ai e konfirmoi një gjë të tillë me urdhër të komandantit të incidentit ne filluam të bënim të pamundurën që gjatë nxjerrjes së tij të mos dëmtohej trupi i tij, në mënyrë që mos t'i shkaktojmë plagë tjera". Rreshter Trolli tregon momentet emocionuese gjatë punës së pjesëtarëve të FSK-së për nxjerrjen e trupit të gjallë nga gërmadhat. " Gjatë nxjerrjes së tij ne kemi komunikuara më të, duke e motivuar që të qëndroi i qetë, sepse ne do të shpëtojmë atë". "Shumë shpejt do të nxjerrim nga këtu"- ishin fjalët tona, derisa gjatë të kohës i mbijetuari kërkonte ndihmë që ta nxirrnim nga aty.

Sipas rreshter Trollit finalizimi i kësaj pune të suksesshme ka qenë momenti kur ekipi profesional i FSK-së ka arritur ta nxjerrë të gjallë këtë person dhe tua dërgojë ekipeve mjekësore.

"Ka qenë një ndjenjë e papërshkrueshme kur e kemi nxjerr personin të gjallë nga gërmadhat, ku të gjithë pjesëtarët e Kërkim-Shpëtimit Urban i kam parë që janë motivuar akoma më shumë për të vazhduar kërkimet për personin tjetër dhe nga kjo punë e bërë në këtë incident mund të përfundoj që ekipi i Task Forcës së Kërkim-Shpëtimit është i përgatitur profesionalisht për të intervenuar çdoherë në ndihmë të qytetarëve të Kosovës kurdo që kërkohet- thotë ai.

Krenare që është pjesë e FSK-së dhe që iu është dhënë mundësia që të ndihmojë në shpëtimin e jetës së Tefik Belës po ashtu edhe të nxjerrjes së dy kufomave tjera të ngujuar nën gërmadha ishte edhe ushtarja e Kërkim Shpëtimit, Besarta Pacolli. "Tek unë ishte një ndjenjë e veçantë ngase më parë nuk kisha marrë pjesë në operacione të kësaj natyre. Asnjë nga pjesëtarët nuk po mendonim për rrezikun që na kanosej, por vetëm se si të arrijmë t'i nxjerrim sa më shpejt personat e ngujuar nën rrënoja. Ishte një ndjenë shumë e keqe momenti kur u nxor viktima e parë ngase të gjithë po shpresonim se do të ishte gjallë. Kjo ishte një shtysë që ne të vazhdonim përpara në mënyrë që personat tjerë të nxirreshin sa më parë dhe gjallë. Mirëpo falë Zotit pas disa orësh kërkimi ne gjetëm një person të gjallë i cili ishte ngujuar nën rrënoja, Kjo më bëri të ndjehem shumë krenare, sepse isha pjesë e ekipit që shpëtuam një person, pothuajse në momentet e fundit të jetës "

Ndërsa për udhëheqësen e ekipit mjekësor gjatë këtij operacioni nëntoger Fitntete Seta kjo nuk ishte hera e parë që ajo intervenonte në operacione reale, por prapë se prapë emocioni dhe ndjenja që mund t'i ndihmosh dikujt moralisht dhe profesionalisht për të janë gjëra që nuk mund të përshkruhen me fjalë. "Ne të gjithë pjesëtarët e FSK jemi të trajnuar dhe të përgatitur profesionalisht për të qenë të gatshëm për rastet reale nëse na ndodhin në befasi të ndryshme. Normal të përballesh me realitetin në raste reale të fatkeqësive të ndryshme është emocionuese sepse jeta e dikujt varet nga ti, në aspektin profesional. Për mua nuk është hera e parë që kam rastin edhe mundësinë që të jap kontributin tim moral dhe profesional në ndihmë të popullit tim, po ashtu edhe më gjerë siç ishte rasti i vërshimeve në Shkodër. Për secilin rast emocionet janë të veçanta, e në raste të shpëtimit të jetëve emocioni nuk përshkruhet me fjalë. Të shpëtosh një jetë siç ishte rasti i fundit i Tefik Beles në incidentin e ndodhur në Obiliq, është një emocion i jashtëzakonshëm, unë ndihem shumë e lumtur në rast se kontributi im dhe ndihma ime ka shërbyer sadopak për të shpëtuar jetën e këtij personi" thotë udhëheqja e ekipit mjekësor në këtë operacion nëntoger Fitnete Seta.

Profesionalizmi i FSK-së në realizimin e intervenimit të suksesshëm në Korporatën Kosova

Sipas komandantit të incidentit Agron Bajrami, intervenimi i FSK-së ka qenë thelbësor për menaxhimin e situatës dhe sigurisht se pa ekipet profesionale të FSK-së operacioni nuk do të përfundonte me shpëtimin e jetës së punëtorit nën gërmadha dhe gjetjen e trupave të pajetë të dy punëtorëve të tjerë brenda një afati të shkurtër kohor. "Urdhrat dhe udhëzimet e stafit udhëheqës të Komandës së Forcave Tokësore kanë qenë të qarta, mbështetja ka qenë e plotë nga të gjitha nivelet dhe kjo na ka ndihmuar që të arrijmë suksesin e plotë në operacion. Çështjet e koordinimit të veprimeve të FSK-së me institucionet tjera ishin në nivel të kënaqshëm dhe përfundimisht mund të vlerësojmë se ekipet tona janë të pazëvendësueshme gjatë situatave të tilla. Puna ekipore dhe efikasiteti i veprimeve të forcave ka rezultuar me një operacion të shpejtë dhe të suksesshëm". Mirëpo pas përfundimit të operacionit është bërë analiza fillestare (analiza e nxehtë) dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit janë evidentuar aspektet që kërkojnë përmirësim në të ardhmen që FSK të rris edhe më tej efikasitetin, të shkurtojë kohën e reagimit dhe përfundimisht të avancojë planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve. Por pavarësisht kësaj nënkolonel Bajrami thekson se FSK edhe kësaj radhe ka dëshmuar se është institucion profesional, i gatshëm për të mbështetur qytetarët dhe institucionet e vendit në të gjitha situatat pa marrë parasysh rrezikun me të vetmin qëllim shpëtimin e jetës së qytetarëve. "FSK me veprimet e veta ka dhënë shembullin më të mirë të një institucioni të organizuar, efikas, të disiplinuar dhe me moral të lartë ushtarak. Forca e Sigurisë së Kosovës duhet t'i mirëmbajë këto kapacitete për reagim dhe të avancojë me detyra të reja në të ardhmen. Të gjithë pjesëmarrësit në operacion dëshiroj t'i falënderoj dhe u jam mirënjohës për punën dhe angazhimin e tyre në shërbim të vendit. Një falënderim i veçantë për oficerët komandues të KFT-së, BMO-së dhe Ministrinë e FSK-së për mbështetje gjatë gjithë kohës së zhvillimit të operacionit.





FSK-ja mbajti ushtrimin fushor të komunikimit "Pëllumbi-1"

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), më 16 qershor, filloi mbajtjen e ushtrimit fushor të koduar me emrin "Pëllumbi-1".

Qëllimi i mbajtjes së ushtrimit fushor ishte demonstrimi, zhvillimi dhe mirëmbajа e kapaciteteve operacionale nga njësitë e nivelit taktik dhe operativ, për organizim, planifikim dhe mbështetje me komunikim njësitet e FSK-së.



Në ditën e tretë të mbajtjes së këtij ushtrimi, më 18 qershor, për një vizitë zyrtare, në fshatin Cërnushë të Vushtrisë, qëndroi shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel Naim Haziri së bashku me nënkolonelët Ilir Shyti dhe Bashkim Shillova.

Me këtë rast, shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Naim Haziri, u shpreh i kënaqur me realizimin e ushtrimit, duke marrë parasysh rolin që kanë mjetet e komunikimit. Kolonel Haziri i përgëzoi pjesëtarët e komunikimit për suksesin e arritur: " Ju përgëzoi për suksesin e treguar gjatë këtij ushtrimi, ju duhet të vazhdoni të punoni intensivisht që të arrini ti eliminoni ndonjë nga mangësitë eventuale në të cilat keni hasur gjatë ushtrimit".

Ndërsa, komandanti i Kompanisë së Komunikimit kapiten Fatmir Kajtazi, tha: "Qëllimi i këtij ushtrimi ka qenë mbështetja me komunikim për të gjitha njësitet në terren, duke përdorur të gjitha kapacitetet që posedon FSK-ja, dhe ndjehem shumë mirë që ushtrimi ka rezultuar të jetë



mjaft i suksesshëm".

Synimi i këtij ushtrimi ishte të bëhet testimi i personelit, testimi i sistemeve dhe i pajisjeve të komunikimit, të njësiteve vartëse që të zhvillojnë komunikim të mirëfilltë, si dhe të testojnë dhe shfrytëzojnë të gjitha pajisjet dhe nivelet e komunikimit.

Në ushtrimin fushor morën pjesë të gjitha njësitet e komunikimit të FSK-së, ndërsa, qendrat e zhvillimit të ushtrimit ishin: Peja, Klina, Shtimja dhe Vushtrria. Ushtri fushor "Pëllumbi-1", gjatë të cilës kohës së mbajtjes së tij, u monitorua nga një ekip profesional i Gardës Kombëtare të Ajowws (IOWA-s) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Kadetët e FSK-së në ushtrimin fushor ndërkombëtar në Krivollak të Maqedonisë, treguan rezultate të shkëlqyeshme





Me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, një njësit i kadetëve të FSK-së, mori pjesë në Ushtrimin Fushor Ndërkombëtar "Kampi Veror 2014" nga data 10-20 qershor 2014, së bashku me kadetët nga: Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia, Mali i Zi dhe Maqedonia si nikoqire.

Ky është viti i pestë rresht, që po mbahet ushtrimi i kadetëve në Krivollak të Maqedonisë. Qëllimi i mbajtjes së tij është përgatitja për operacione të paqes, si edhe veprimi i përbashkët si një trup të ushtarakëve të vendeve të rajonit, në raste të misioneve kudo dhe kurdo që kërkohet të angazhohen duke zbatuar të njëjtën doktrinë, atë të NATO-s.


"Kjo është një ngjarje jashtëzakonisht e rëndësishme për FSK-në, sepse kadetët tanë treguan një përgatitje të lartë profesionale dhe ishin ndër më të mirët gjatë mbajtjes së këtij ushtrimi. Kjo na gëzon më shumë sepse FSK-ja po tregon në praktikë se është një forcë profesionale dhe e cila mund të krahasohet dhe të jetë përkrahë me të gjitha ushtritë e rajonit dhe ushtritë e NATO-s"-tha nënkolonel Hasan Hoxha.

Vetë pjesëmarrja e kadetëve të FSK-së, në ushtrime rajonale është dëshmi se FSK-ja, po arrin me sukses plotësimin e kapaciteteve dhe kritereve me standarde më larta të shteteve anëtare të NATO-s.

Në ditën e fundit të mbajtjes së ushtrimit fushor "Kampi veror 2014", morën pjesë ushtarakë të ushtrive të vendeve të rajonit dhe të ushtrive pjesëmarrëse të cilët e përcollën nga afër operacionin në Poligonin Ushtarak në Krivollak të Maqedonisë, ndërsa nga FSK-ja mori pjesë nënkolonel Hasan Hoxha nga Departamenti për Siguri dhe Bashkëpunim në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe major Enver Voca.

Kadetët e FSK-së, në Kampin ushtarak në Krivollak të Maqedonisë, kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme, si në nivelin ekipor dhe atë individual (morën pjesë 10 kadetë dhe një oficer)

Kadetët e FSK-së gjatë këtij operacioni u vlerësuan shumë të mirët si "oficerë të ndërveprushëm".



Certifikohen 22 pjesëtarë të FSK-së edhe në lëmin e inteligjencës dhe sigurisë



Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në një ceremoni të organizuar u certifikuan 22 pjesëtarë të FSK-së, të cilët kanë kryer kursin në lëmin e inteligjencës dhe sigurisë. Trajnimi është realizuar në kuadër të marrëveshjes bilaterale në mes të FSK-së dhe SHBA-s. Këtë kurs e kanë ndjekur pjesëtarë të gjitha njësive të FSK-së, si dhe pjesëtarë të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Me rastin e certifikimit, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, falënderoi instruktorët amerikanë për ndihmën që po japin në përgatitjen dhe trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së, ndërsa nga të sapo certifikuarit kërkoi që njohuritë e fituara t'i avancojnë edhe më tej, në njësitet e tyre.

Ndërsa, nënkolonel Bruce Murfy, nga ambasada e Amerikës në Prishtinë, tha: "Ndjehem i lumtur që jemi duke dhënë një kontribut në këtë drejtim dhe po kemi mundësi ta ndihmojmë FSK-në".

Ky cikël trajnimesh do të vazhdojë edhe në të ardhmen në kuadër të bashkëpunimit në mes Ministrisë së FSK-së dhe Qeverisë së Amerikës.

Certifikohen 21 pjesëtarë të Taskë Forcës për Paramedikë



Në kazermën e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) "Evropianët e Rinj" në Pomozotin, më 27 qershor 2014, u mbajt ceremonia e certifikimit të 21 pjesëtarëve të Task Forcës, të cilët përfunduan trajnimin dyjavor për Paramedikë, realizuar nga ekipi i instruktorëve të Mbretërisë së Bashkuar. Pjesëmarrësit e ceremonisë, fillimisht, përcollën nga afër demonstrimin e pjesëtarëve të Task Forcës me rastin e intervenimit në një aksidenti në komunikacion.

Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral major Rrahman Rama e cilësoi mjaft efikas këtë trajnim dhe i përgëzoi pjesëtarët për rezultatet e treguara " E falënderoj Mbretërinë e Bashkuar dhe të gjithë instruktorët të cilët kanë bërë një punë mjaft të madhe në këtë trajnim si edhe në trajnimet e shumta të cilat janë duke i realizuar për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës". Për ta përcjellë ceremoninë kishin ardhur edhe sekretari i përgjithshëm Ministrisë së FSK-së, dr. Shkëlzen Sylaj, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, komandanti i Taskë Forcës, kapiten Haki Hertica, këshilltari i Komandantit të FSK-së, kolonel David Jones, ekipi i instruktorëve që realizuan trajnimin si dhe udhëheqës të lartë të MFSK-së dhe FSK-së



Pjesëtarë të Batalionit të Dytë të BRSH-së marshojnë 25 km

Batalioni i Dytë i Brigadës për Reagim të Shpejtë i FSK-së në Istog, më 13 qershor 2014, ka realizuar marshimin e radhës administrativo kondicional të ashtuquajtur "Vera 2014".

Pikënisja e këtij marshimi ishte lagjja Vitomericë (Pejë) dhe caku kazerma "Ushtarët e NATO-s" në Istog. Në marshim morën pjesë 169 pjesëtarë të Batalionit të Dytë, me 17 automjete të ndryshme, të cilët e kanë përfunduar marshimin me sukses në një gjatësi mbi 25 kilometra.

"Ky marshim si dhe marshimet e tjera po realizohen me sukses dhe janë të parapara në kalendarin vjetor të stërvitjes të Batalionit të Dytë" na thotë në fund, tetari Hysni Kelmendi, zyrtar për informim në Batalionin e Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog.



Pjesëtarë të komuniteteve në FSK kryen kursin tremujor të gjuhës shqipe



Në ambientet e Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Gjilan, më 26 qershor 2014, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, nga radhët e komuniteteve me rastin e përfundimit të kursit të gjuhës shqipe.

Me këtë rast, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Agim Ceku e vlerësoi shumë të rëndësishëm kryerjen e kursit të gjuhës shqipe, për pjesëtarët e FSK-së, nga radhët e komuniteteve. Ai, përveç tjerash, tha: "E vlerësoj si një arritje shumë të madhe, sepse është një hap i rëndësishmen për shumë arsye; FSK-ja është një forcë që mburret me suksesin e vet, me vlerat e veta, por vlera kryesore të FSK-së, janë profesionalizmi, disiplina, përkushtimi, multnietniciteti dhe barazia gjinore. Ky është një element që FSK-ja vlerësohet shumë brenda dhe jashtë Kosovës, miqtë



tanë ndërkombëtarë, e marrin si shembull të mirë këtë vlerësim. Për sa i përket përfshirjes së gruas dhe pjesëtarëve të komuniteteve, jemi shumë para ushtrive tjera sepse kemi një përqindje të mirë që neve na bënë të ndihemi mirë, atëherë merita e parë ju shkon juve, ju drejtua ministri pjesëtarëve të komunitetit serbë dhe boshnjak, për të shtuar: "Që në fillim e keni marrë një vendim të drejtë, të mirë, për t'iu bashkuar FSK-së, për këtë unë ju përgëzoj. Ju me kryerjen e këtij kursi keni treguar vullnet ta mësoni gjuhën shqipe, të bashkëpunoni, të bashkëveproni me shumicën e ushtarëve shqiptarë dhe të bisedoni lirshëm me njeri- tjetrin drejtpërdrejt. Me angazhimin tuaj në FSK e keni ndihmuar në radhë të parë veten, por e keni ndihmuar edhe FSK-në". Në fund ministri Ceku i përgëzoi dhe u uroi suksese të tjera pjesëtarëve të komunitetit serbë dhe boshnjak të cilët kanë kryer kursin e gjuhës shqipe.

Komandanti i Batalionit të Parë të BRSH-së, nënkolonel Haki Xhemjali, tha: "Organizimi dhe mbajtja e kursit të gjuhës shqipe, tregon vullnetin dhe gatishmërinë e FSK-së, për të afruar mundësi sa më të mëdha të integrimit dhe të bashkëpunimit pa dallime etnike, fetare dhe gjinore. Trajtimet e tilla janë mundësi të barabarta për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, ndërsa në Batalionin e Parë të (BRSH) tani më është kthyer në parim dhe ky është shembulli më i mirë i synimeve tona të përbashkëta drejt së ardhmes".

Kursi i gjuhës shqipe ka filluar të mbahet më 4 mars 2014 dhe ka përfunduar (cikli i parë) më datën 23 qershor 2014. Në ceremoninë e mbajtur me këtë rast morën pjesë: ministri FSK-së, Agim Çeku, zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i Komandës së Forcave Tokësore (KF'T), gjeneralmajor Rrahman Rama, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, komandanti i Batalionit të Parë të BRSH-së, nënkolonel Haki Xhemajli, përfaqësues të KFOR-it, si dhe oficerë dhe ushtarë të FSK-së.

Në fund, ministri Ceku, gjeneral Rama, gjeneral brigade Brahimaj dhe përfaqësuesi i KFOR-it, për të gjithë pjesëmarrësit ndanë certifikata për kryerjen me sukses të këtij kursi.

36 pjesëtarë të FSK-së, kryejnë trajnimin "Taktikat me Njësi të Vogla", në Istog

Në ambientet e kazermës "Ushtaret e NATO-s" në Istog, të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), më 27 qershor 2014, u mbajë ceremonia e certifikimit të 36 pjesëtarëve të kësaj Brigade, pas përfundimit të trajnimit, katër javor: "Taktikat me Njësi të Vogla".

Në ceremoninë e certifikimit, morën pjesë: komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, kolonel Xhevahir Geci, zëvendëskomandant i BRSH-së, nënkolonel Haki Xhemajli, komandant i Batalionit të Parë të BRSH-së, si dhe oficerë të lartë të Shtabit të BRSH-së.

Me këtë rast, komandanti i BRSH-së, gjeneral Brahimaj, tha, se trajnimi ka qenë i suksesshëm, mjaftë sfidues dhe me prioritet për FSK-në: "Trajnimi, "Taktikat me Njësi të Vogla" ka qenë dhe do të mbetet prioritet



duke u bazuar në dy arsye kryesore: e para, është trajnim që ka dëshmuar për dhënien e fryteve pozitive në aspektin e ngritjes profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, në kuadër të misionit aktual që ka FSK-ja, dhe e dyta, është trajnim i cili ndërlidhet plotësisht me detyrat që do t'i kenë në të ardhmen Forcat e Armatosura të Kosovës".

Më pastaj, komandanti i BRSH-së, gjeneral Brahimaj, iu drejtua të posa certifikuarave:"Unë dhe stafi im, gjatë gjithë kohës së mbajtjes së trajnimit, ju kemi përcjellë dhe jemi të vetëdijshëm për vështirësitë nëpër të cilat keni kaluar, kur kemi parasysh nivelin sfidues të këtij trajnimi, megjithatë kjo është ajo që kërkohet nga ne, përgatitja profesionale, fizike dhe psikike".

Gjeneral Brahimaj, kërkoi nga të certifikuarit që njohuritë e fituara gjatë trajnimit t'i bartin me sukses tej njësitë e tyre.

Trajnimi "Taktikat me Njësi të Vogla" ka filluar më 02 qershor dhe ka përfunduar më 27 qershor 2014, ka qenë trajnim, rezident, ndërsa trajnimin e kanë kryer 36 pjesëtarë, 29 prej tyre nga BRSH-ja dhe 7 nga Brigada për Mbështetjes Operacionale (BMO) dhe Regjimenti i Mbrojtjes Civile (RMC). Kjo është gjenerata e dytë për vitin 2014, ndërsa gjenerata e pestë në përgjithësi, që e organizon dhe realizon Brigada për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Istog.

Gjatë këtij trajnimi pjesëtarët e FSK-së janë pajisur me njohuri të reja, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik, në fusha të ndryshme, ndërsa fokusi kryesor ka qenë ngritja dhe profesionalizimi i pjesëtarëve të BRSH-së dhe BMO-së, për këto tema të veçanta: Aftësimi i pjesëtarëve në udhëheqje dhe operim me ekipe dhe skuadra, rikonicionim, repilim, navigim tokësor i kombinuar ditën dhe natën, qitja taktike dhe stresuese me armë, operacione urbane dhe tema tjera. Në fund, gjeneral Brahimaj, kolonel Geci dhe nënkolonel Xhemajli, për të gjithë pjesëtarët e këtij trajnimi ndanë certifikata, ndërsa për të dalluarit ndanë shpërblime dhe për instruktorët mirënjohje.

FSK-ja shënoi përvjetorin e 45-të të lindjes së dëshmorit Ilir Konushevci



Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, FSK-ja, më 20 qershor 2014, shënoi 45 vjetorin e lindjes së dëshmorit të kombit Ilir Konushevci. Në shenjë kujtimi dhe respekti për dëshmorin Ilir Konushevci u bënë homazhe dhe u vendosen kurora lulesh pranë bustit të tij. Në shënimin e këtij përvjetori morën pjesë: komandanti i Brigadës Mbështetëse Operacionale (BMO), gjeneral brigade Ilaz Dërguti, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel NaimHaziri, komandanti i Batalionit të Xhenios, nënkolonel Zejnullah Prokshi, pjesëtarë të FSK-së, si dhe familjarë të dëshmorit, Ilir Konushevci.

Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë zhvilluan ndeshje miqësore në futboll

FSK - FASH 0:0

Stadiumi i Prishtinës

Gjyqtarë: Hilmi Zariqi, kryesor dhe Ramadan Bekteshi e Kujtim Krasniqi, anësor

FSK: Bujar Mangjolli, Përparim Jakupi, Lulzim Gashi, Blerim Vilanci, Faton Rustemi, Semir Zvërko, Tomë Lleshi, Binak Podrimqaku, Hysni Gjinovci, Albert Selimi, Arbnor Jakupi,

FASH: Marius Braculla, Mateo Oboni, Gerald Bukri, Besmir Qershia, Renato Dorzi, Rejnaldo Gjerazi, Enkel Lika, Filion Caushaj, Besnik Shehu, Klodjan Terziu, Ornest Cerkrezi,



Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë, më 26 qershor 2014, në stadiumin e Prishtinës, para qindra shikueseve zhvilluan ndeshjen e parë miqësore në futboll të madh, e cila përfundoi baras, pa gola.

Për të përcjellë lojën kishin ardhur ministri i FSK-së, Agim Ceku, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahma Rama, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të Shqipërisë gjeneralmajor Viktor Berdo, zëvendës ministri i FSK-së, Bejtush Gashi, gjeneralët: Halimi, Brahimaj, Cikaqi dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe të FASH-së.

Simbolikisht, topin nga qendra e nisin, gjeneralët: Rama dhe Berdo.

Pjesa e parë ishte mjaftë dinamike, me disa raste shënimi, ku ekipi i FSK-së, pati me shumë raste për të kaluar në epërsi, madje dy herë qëlloi shtyllën por nuk arriti të shënojë gol.

Ndërsa, ekipi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë nuk pati shumë raste në pjesën e parë, kështu që të dy skuadrat shkuan në pushim pa gola.



Edhe pjesa e dytë filloj me një dinamikë të mirë, ku loja u baraspeshua dhe të dyja ekipet patën raste shënimi. Ekipi i FSK-së përsëri qëlloi shtyllën, por prapë nuk arriti të shënojë gol, derisa ekipi i FASH-it, pati disa raste para portës së ekipit të FSK-së, por nuk arrit t'i konkretizojë.

Në pjesëlojën e dytë, edhpse të dy trajnerët sprovuan edhe shumë lojtarë të rinj, golat mbetën të paprekura, dhe loja përfundoi me rezulltatë të barabartë 0:0.

Në fund, morën edhe prononcimet e dy trajnerëve.

Afrim Nebihu shef i shtabit të ekipi të FSK-së, tha:

"Jemi një kohë të gjatë duke u përgatitur ku FSK-ja bënë aktivitete në futboll të vogël dhe të madh. Këtë herë kemi organizuar një ndeshje me Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Ka qenë një lojë e mirë. Këto takime janë në kuadër të bashkëpunimit, dhe ndeshje të tilla do të luajmë me Maqedoninë, Malin e Zi, dhe shtetet tjera" tha në fund, z. Nebihu.

Ndërsa, Gernad Qirici përfaqësues i ekipit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, tha: "Sot luajtëm një ndeshje miqësore me vëllezërit nga Kosova, në kuadër të miqësisë, me moton miqësi nëpërmjet sportit. Ishte një ndeshje e bukur ku siç e patë fitoi miqësia, fitoj sporti, fitoj gjithçka. Urojmë dhe shpresojmë që Forca e Sigurisë së Kosovës së shpejti do të jetë Forca e Armatosur e Kosovës. E meriton në të gjitha drejtimet", tha Qirici.

Të dy trajnerët premtuan se ndeshje të tilla do të do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, madje do të intensifikohen edhe me vendet tjera.

Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Forca e Sigurisë së Kosovës do ta zhvillojnë ndeshjen e kthimit në shtator të këtij viti, në Tiranë.

KFOR-i dhe FSK-ja treguan futboll të nivelit të lartë

Për të përcjellë ndeshjen miqësore në futboll të madh, në mes KFOR-it dhe FSK-së, që u luajt në stadiumin e Prishtinës, kishin ardhur edhe komandanti i KFOR-it, gjenerali Salvatore Farina, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ambasadorja e Francës dhe Zvicrës, ushtarë të KFOR-it dhe FSK-së, si dhe shumë futbolldashës.

Ndeshja u referua nga gjyqtarët e rinj me mjaft autoritet nga Prishtina.

Të dyja ekipet treguan futboll të mirë, që u karakterizua me aksione të shpejta të koordinuara mirë dhe në përgjithësi loja ishte në kufij e ferplejit, me çka u konfirmua edhe një herë bashkëpunimin e



mirë që ka FSK-ja me miqtë e saj e në veçanti me forcat e NATO-s, që janë në Kosovë(KFOR-in).

Në pjesën e parë për një nuancë u dalluan futbollistët e FSK-së, të cilët shënuan dy gola, edhe futbollistët e KFOR-it, patën rastet e tyre, por portieri i FSK-së, i cili reagoi me



kohë dhe kështu rrjeta e tij mbeti e paprekur.

Edhe pjesa e dytë dallohet me aksione të shpejta dhe të menduara mirë, por portat e të dyja ekipeve mbetën të paprekura. Fitorja i takoi ekipit të FSK-së.

Në fund të ndeshës për lojtarët e të dyja ekipeve u ndanë mirënjohje.

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 26 • Gusht 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i FSK-së, Agim Çeku priti në vizitë komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara të Aleancës në Napoli, admiralin Bruce Clingan

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Agim Çeku, më 21 korrik, priti në vizitë komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara të Aleancës (KFBA) në Napoli, admiralin Brus Clingan, si dhe pasardhësin e tij në detyrë admiralin Mark Ferguson III, të shoqëruar edhe nga komandanti i Forcave Paqeruajtëse të KFOR-it, gjeneral major Salvatore Farina.

Në takimin e përbashkët të ministrit Çeku me ushtarakët e lartë të NATO-s, morën pjesë: komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, sekretari i Përgjithshëm Shkëlzen Sylaj dhe këshilltarja e ministrit zonj. Besa Kabashi Ramaj.

Me këtë rast, ministri Çeku e njoftoi admiralin Clingan mbi të arriturat e deritanishme të FSK-së, si dhe për dinamiken e procesit në të cilën ndodhet aktualisht. Gjithashtu, ministri Agim Çeku e njoftoj admiralin Clingan mbi procesin e implementimit të rekomandimeve të dala nga procesi i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Nga ana e tij admirali Clingan shprehu interesimin dhe angazhimin e tij të pakursyer dhe përkrahjen për FSK-në, në rrugën e zhvillimit të saj. Admirali Clingan u shpreh, gjithashtu se Komanda e Bashkuar e Forcave të Aleancës në Napoli, me vëmendje po i përcjell zhvillimet në Republikën e Kosovës, sa i përket fushës së sigurisë, dhe se Napoli është i bindur se Kosova është në rrugë të drejt.



Admirali Clingan, gjithashtu tha se, edhe pasardhësi i tij në detyrë, admirali Ferguson është shumë i interesuar që bashkëpunimi në mes të KFBA-së, në Napoli dhe FSK-së, të vazhdoi dhe në të ardhmen, ashtu siç ka qenë deri më tani.

Komandant i Komandës së Bashkuar të Forcave të Aleancës në Napoli, admiralit Brus Clingan vizitoi për herë të fundit ministrinë për FSK, në cilësinë e komandantit të KFBA.

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën ndihmës Sekretaren e Mbrojtjes të SHBA-s

Në ambientet e Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës, ministri i MFSK-së Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 13 korrik, pritën në takime të ndara, ndihmës Sekretaren e Ministrisë së Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) për Rusi, Ukrainë dhe Euro Azi, z. Evelyn Farkas e shoqëruar nga gjeneral major Rady KEE.

Ministri Çeku i informoi mysafirët me rezultatet e arritura, zhvillimin aktual në FSK dhe angazhimet për ngritje dhe profesionalizim të mëtejmë në përputhje edhe me rekomandimet e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës.

Me këtë rast, ministri Çeku falënderoi ndihmës Sekretaren e Mbrojtjes, znj. Farkas dhe gjeneralin KEE, për mbështetje të vazhdueshme që po japin Shtetet e Bashkuara të Amerikës për zhvillimin dhe rritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ndërsa, ndihmës Sekretarja e Mbrojtjes znj. Farkas falënderoi Ministrin Çeku për pritjen dhe premtoi se edhe në të ardhmen SHBA do ta ndihmojë dhe mbështes FSK-në në transformimin e saj në Forca të Armatosura të Kosovës.

Ndihmës Sekretarja e Mbrojtjes znj. Farkas gjithashtu pati takim edhe me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastratin. Gjeneral Kastrati e informoi znj. Farkas rreth angazhimeve të FSK-së, për operacionet e vazhdueshme të deminimit, kërkim - shpëtimit dhe ato humanitare. Theks të veçantë në këtë takim iu kushtua stërvitjes, shkollimit dhe edukimit të pjesëtarëve të FSK-së.

Të dyja palët u pajtuan se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen përmes programeve të partneritetit me Gardën Kombëtare të Ajovës dhe Ambasadës amerikane.



Zëvendëskomandanti suprem i Aleancës së NATO-s për Evropë, gjeneral Sir Adrian Bradshaw vizitoi MFSK-në



Ministri në detyrë i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku, më 15 korrik, priti në vizitë zëvendëskomandantin suprem të Aleancës së NATO-s për Evropë, gjeneral Sir Adrian Bradshaw me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit të përbashkët, ministri Çeku e informoi gjeneralin e NATO-s, Bradshaw për të arriturat e FSK-së, duke u shprehur se FSK-ja është tregimi më i suksesshëm i Kosovës së pavarur. Ne, tha ministri Agim Çeku, jemi afirmuar si forcë për të mirë në vend, rajon si dhe partner i besueshëm i NATO-s. Gjithashtu, ministri Çeku gjatë takimit, në emër të MFSK-së e falënderoi gjeneralin Bradshaw për mbështetjen që NATO i ka dhënë FSK-së, si dhe kërkoi nga ai që kjo mbështetje të vazhdojë dhe të rritet edhe më tutje e sidomos tani që po hyjmë në një fazë të re të zhvillimit.

Agim Çeku, ministër në detyrë i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, para gjeneralit Bradshaw u shpreh se presim që NATO ta ndihmojë Republikën e Kosovës në ngritjen e kapaciteteve ushtarake të mbrojtjes, në vendosjen e raporteve formale të partneritetit (anëtarësimi



në Partneritet për Paqe-PFP). Gjithashtu, ministri Çeku kërkoi qasje në shkolla të NATO-s, në ushtrime, si dhe Kosova të marr pjesë në misione paqeruajtëse të NATO-s. Në fund, ministri Çeku e siguroi zëvendëskomandantin suprem të Aleancës së NATO-s për Evropë, gjeneralin Adrian Bradshaw se Kosova po ecë drejt marrjes së përgjegjësive për sigurinë e vetë, dhe se gjithashtu Kosova ende ka nevojë për mbështetjen, asistencën dhe këshillat e NATO-s, në mënyrë që të evoluojmë bashkë me NATO-n, duke ditur edhe faktin se populli i Kosovës dhe Qeveria e vendit e ka synim anëtarësimin në NATO.

Nga ana e tij, gjenerali i NATO-s, Adrian Bradshaw tha: NATO e çmon aspiratën e Kosovës për anëtarësim në NATO, si dhe çmon gatishmërinë e Kosovës për të kontribuar në misione paqësore. Ai tha, se ka parë përparime shumë të mëdha në ngritjen e kapaciteteve të sigurisë, dhe për këtë ndjehet i lumtur për arsye se NATO-ja është e angazhuar këtu për një dekadë e gjysmë. Gjenerali Bradshaw theksoi sidomos punën e gjatë të përbashkët me ministrin Çeku, si edhe me organizatën në tërësi, pra marrëdhënie të mira dhe shumë pozitive të cilat duhet vazhduar edhe më tutje. Në fund, gjenerali i NATO-s, Bradshaw tha se FSK-ja do të ecë përpara në ngritjen e kapaciteteve të saj dhe se bashkëpunimi dhe mbështetja nga ana NATO-s nuk do të mungojë.

Në pritje, ministri i FSK-së u shoqërua nga zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama dhe sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës për nderë të gjeneralit të NATO-s organizoi ceremoni zyrtare, dhe e veçanta e kësaj ishte se Njësia Ceremoniale e FSK-së, për herë të parë u paraqit me uniformën e re tradicionale.

Ministria e FSK dhe Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë nënshkruan dy protokolle bashkëpunimi

Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), Muhamet Latifi, dhe zëvendësministri i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Dritan Hila, më 7 korrik 2014, nënshkruan në Tiranë, protokollet "mbi bashkëpunimin dhe asistencën në fushën e integrimit euro-atlantik dhe rajonal", si dhe "mbi bashkëpunimin në fushën e arsimimit dhe trajnimit ushtarak" ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë.

Qëllimi i këtyre protokolleve është bashkëpunimi, koordinimi i përbashkët dhe asistenca për MFSK-në në procesin e anëtarësimit në strukturat e sigurisë kolektive të NATO-s dhe iniciativave rajonale, si dhe vendosja e bashkëpunimit në fushën e arsimimit dhe trajnimit ushtarak ndërmjet dy vendeve.

Protokollet janë nënshkruar me rastin e vizitës së delegacionit të MFSK-së, kryesuar nga zëvendësministri i FSK-së, Muhamet Latifi, si dhe në përbërje të gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së, kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, nënkolonel Enver Dugolli, atashe i FSK-së në Republikën e Shqipërisë dhe Petrit Ajeti, zyrtar i lartë për IPA dhe koordinim të donacioneve në MFSK.



Komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati priti një delegacion të ushtrisë së SHBA-s për Evropë (EUCOM)



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Kadri Kastrati, së bashku me komandantin e Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral-major Rrahman Rama dhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e FSK-së, më 29 korrik, pritën në një takim zyrtarë, një delegacion të oficerëve të lartë amerikanë të EUCOM-it, (Komanda Amerikane për Evropë) të prirë nga kundëradmirali Patrick Piercey, zëvendës i Departamentit për Politika dhe Plane në EUCOM, kundëradmirali Marc Dalton me bashkëpunëtorë.

Qëllimi i takimit të sotëm ishte vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet EUCOM-it dhe FSK-së, dhe ishte një takim njohës me zëvendësin e kundëradmiralit Patrick Piercey, kundëradmiralin Marc Dalton.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati falënderoi delegacionin e EUCOM-it, për përkrahjen e vazhdueshme amerikane për FSK-në, në avancimin e mëtejshëm dhe bashkëpunimin e mirë që ka me FSK-në. Ai, gjithashtu e njoftoi delegacionin e EUCOM-it edhe me të arriturat e përgjithshme dhe zhvillimet e reja të FSK-së.

Në fund, gjeneral Kastrati falënderoi kundëradmiralin Patrick Piercey, për bashkëpunimin e mirë të deritashëm si dhe theksoi se këtë bashkëpunim do ta vazhdojë edhe me kundëradmiralin Marc Dalton.

Në fund, kundëradmirali Patrick Piercey e ka falënderuar komandantin e FSK-së, gjeneral Kastratin për bashkëpunimin e deritanishëm të EUCOM-it dhe FSK-së.

Atashetë ushtarak të akreditуar në Republikën e Kosovës njoftohen për të arriturat e FSK-së

Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, në Prishtinë, më 2 korrik 2014, u mbajt takimi i radhës me atashetë ushtarak të akreditуar në Republikën e Kosovës. Në takim morën pjesë: ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati si dhe stafi i lartë i MFSK-së dhe FSK-së.

Në fjalën e tij, ministri Çeku, falënderoi të gjithë atashetë ushtarakë për angazhimin dhe për bashkëpunimin e mirë që kanë me FSK- në, dhe më pastaj i njoftoi për situatën e tanishme politike dhe ndikimin që ka kjo në proceset e FSK-së. Ministri foli edhe për procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë(RSSS) si dhe planin e implementimit të RSSS-së.

Gjithashtu, ministri në largim Agim Çeku, gjatë takimit i njoftoi atashetë me disa nga të arriturat e FSK-së, si intervenimin me sukses në Termocentralin "Kosova A" dhe pjesëmarrjen e kadetëve të FSK-së, në "Kampin Veror 2014," mbajtur në Krivollak të Maqedonisë.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i njoftoi atashetë për ngritjen e vazhdueshme të FSK-së, si një forcë profesionale dhe shumë etnike, për mirëmbajtjen e kapaciteteve operacionale, angazhimin në deminim, operacionet e kërkim-shpëtimit dhe për projektet humanitare të FSK-së. Me pas në fjalën e tij ai shtoi: "Gatishmëria për të reaguar sa më shpejtë dhe më efikasitet e FSK-së, në rast të ndonjë krize apo fatkeqësie është treguesi më i mirë i moralit të lartë dhe profesionalizimit të pjesëtarëve të saj.

Rasti i shpërthimit në Termocentralin "Kosova A" dhe reagimi profesional i FSK-së, është edhe një shembull tjetër, që tregon se FSK tashmë ka arritur standarde të larta profesionale dhe gatishmëri të lartë për të reaguar"- tha në fjalën e tij komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati.

Ndërsa për bashkëpunimin rajonal të FSK-së, gjeneral Kastrati u shpreh: "FSK ka treguar gatishmëri për të bashkëpunuar me forcat e vendeve të rajonit dhe po merr pjesë nëpër shumë aktivitete, ushtrime dhe trajnime të përbashkëta me vendet e rajonit dhe më gjerë. Këto arritje janë bërë vetëm me gatishmërinë dhe impenjimin e vendeve partnere, pra vendeve tuaja të cilat e kanë përkrahur dhe po e përkrahin vazhdimisht FSK-së, në ngritjen e vazhdueshme profesionale përmes trajnimeve, shkollimeve, asistencës me pajisje dhe këshillime në shumë fusha të misionit"

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, ka falënderuar atashetë dhe shtetet e tyre për përkrahjen e vazhdueshme për FSK-në. " Përkrahja juaj e vazhdueshme dhe shumëdimensionale në shumë aspekte si me trajnime, shkollime, pajisje, përmes bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh, padyshim se ka kontribuar që FSK -ja të arrij këtu ku është sot"

Në fund, gjeneral Kastrati kërkoi pjesëmarrjen e FSK-së, për të asistuar dhe për të dhënë kontributin e saj në vendet partnere: "Thënë më qartë ne mendojmë se një apo disa vende partnere mund të marrin përgjegjësinë apo të japin kontributin e tyre që FSK-ja të mund të asistoi me njërën nga fushëveprimet e saj. Po e zëmë pjesën e asistencës për logjistikë do t'ia ofronim Republikës Federale të Gjermanisë, fushën e mjekësisë Mbretërisë së Bashkuar, ngritjen e Njësisë së Kërkim Shpëtimit Regjional dhe Qendrës së Ekselencës SHBA-së dhe Mbretërisë Suedeze, trajnimet për Policinë e Forcës Sllovenisë dhe Italisë"- tha në fund të fjalës së tij gjeneral Kastrati.





Në takimin me atashetë ushtarak, me nga një fjalë rasti, kontribuuan edhe Faruk Geci, i cili foli për planin e implementimit të RSSS-së, nënkolonel Hysen Geci për bashkëpunimin dypalësh të FSK-së dhe nënkolonel Agron Bajrami për të arriturat e përgjithshme të Qendrës së Ekselencës dhe Njësisë së Kërkim-Shpëtimit të FSK-së.

Në këtë takim ishin të pranishëm: atasheu ushtarak i Amerikës kolonel Jejms Kot; atasheu ushtarak i Republikës së Shqipërisë, kolonel Fiqri Hoxha; atasheu ushtarak i Republikës së Turqisë, kolonel Hasan Aydogdu; kolonel Luciano Palcani, atashe ushtarak i Republikës së Italisë; kolonel Dolce Kuzmanov, atasheu ushtarak i Republikës së Maqedonisë; kolonel Ivica Mateshiq, atashe ushtarak i Republikës së Kroacisë; nënkolonel Kurt Jakobson, atashe i Suedisë; nënkolonel Richard Parry, atashe i Mbretërisë së Bashkuar e të tjerë.

Takimet me atashetë ushtarak janë takime të rregullta dhe konfirmojnë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së MFSK-së dhe FSK-së, me ushtritë e vendeve të cilat përfaqësojnë atashetë e akreditуar në Republikën e Kosovës.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Intervistë me pjesëtarë të dalluar të FSK-së, në studime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kolonel Qeriqi me sukses kreu studimet në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë Amerikane në SHBA



Kolonel Ilir Qeriqi së bashku me Kolonel Bashkim Shillovën janë oficerët e parë nga Republika e Kosovës që kanë diplomuar me sukses në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë Amerikane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai me sukses mbrojti temën: "NATO dhe Ballkani-Legjitimiteti dhe Roli i NATO-s në Kosovë", e që është vlerësuar me notën maksimale, për mënyrën e trajtimit të një teme mjaft komplekse, në kohën kur legjitimiteti i intervenimit të NATO-s po trajtohet shumë në panele të ndryshme të diskutimit të çështjeve të sigurisë.

Dërgimi i oficerëve të parë në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë Amerikanë është një rezultat i përkrahjes së vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Forcën e Sigurisë së Kosovës. SHBA është kontribuuesi kryesor në edukim të ushtarakëve të Kosovës me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për misionin e tanishëm dhe të ardhshëm të Forcës. Kjo përkrahje ka qenë vazhdueshme dhe është realizuar në nivele të ndryshme të edukimit, përfshirë këtu trajnimet për nënoficerë, trajnimet bazike të oficerit, trajnimet e avancuara të oficerit, Kolegjin e Shtabit dhe Komandës dhe se fundmi edhe Kolegjit të Luftës.

Për të kuptuar më shumë, rreth shkollimit një vjeçar të Kolonel Qeriqit, në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë Amerikane, biseduam me të.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është misioni i Kolegjit të Luftës të Ushtrisë Amerikane, që ju keni studiuar për një vit, si oficeri i parë nga Kosova?*

Kolonel Qeriqi: Kolegji i Luftës i Ushtrisë Amerikane ka për mision që të përgatisë ushtarakë, civilë dhe udhëheqës ndërkombëtarë të zgjedhur për lider strategjik. Studimet në këtë Kolegj të Luftës, janë të përqendruara në nivelet më të larta të politikës dhe strategjisë kombëtare, planifikimin dhe aplikimin e përbashkët të forcës nga programet e ndihmës ushtarake përmes operacioneve ushtarake deri në zhvillimin e luftës së përgjithshme, analizimin e marrëdhënieve në mes forcës ushtarake dhe objektivave të politikes kombëtare, perspektiven e marrëdhënieve globale në mes kombeve moderne dhe të kuptuarit e pozitës së ushtrisë në strategjinë kombëtare.

Ky institucion ka një histori mbi 100-vjeçare, dhe me një traditë të mirë në përgatitjen e liderëve ushtarakë. Studimet në këtë institucion i kanë përfunduar shumë personalitete të dalluara, qofshin këto politike apo ushtarake nga SHBA dhe vende të ndryshme të botës, ndërsa nga Kosova, gjegjësisht Forca e Sigurisë së Kosovës jemi oficerët e parë, çka na bën të ndihemi të privilegjuar për mundësinë që na është ofruar që të studiojmë në këtë institucion. Ky është një sukses që, personalisht mua, më bën të ndihem mirë dhe krenar.

Gazeta "Forca Jonë": *Ky, ka qenë një program shumë i ngjeshur, sa keni arrit të përshtateni natyrës së punës së Kolegjit?*

Kolonel Qeriqi: "Ne kemi ndjekur programin një vjeçar të studimeve, program shumë i ngjeshur, pasi kanë qenë të ndërlidhura ndërmjet vete mësimi teorik me raste të studimit praktik, përfshirë këtu edhe vizita studimore në institucione të rëndësishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, qofshin këto institucione ushtarake dhe qeveritare. Gjithsesi për programin e studimeve kemi qenë pak a shumë të njoftuar edhe para nisjes për në Shtetet e Bashkuara pasi dihet botërisht që studimet në këtë kolegj konsiderohen të jenë niveli më i lartë i studimeve në sistemin amerikan të arsimit ushtarak, i barasvlershëm me titullin "Magjistër i Studimeve Strategjike të Sigurisë". Unë edhe më parë kam qenë në trajnime në Amerikë, mirëpo kjo ka qenë një sfidë që e kemi tejkaluar me studim dhe angazhim të mirëfilltë".

Ligjëruesit amerikanë e kanë vlerësuar lartë përformancën e Kolonel Qeriqit, me togfjalëshin "oficer i shkëlqyer në çdo aspekt"!

Në raportin e vlerësimit nga stafi akademik dhe komandues i Kolegjit të Luftës, Kolonel Qeriqi ka arritur që të dëshmojë veten si ushtarak dhe studiues profesionist i respektuar, duke qenë kështu një ambasador i shkëlqyeshëm i Kosovës dhe duke dhënë komente përmbajtjesore për disa nga çështjet më delikate në aspektin strategjik global.

Ka kaluar me lehtësi testin me gojë duke qenë jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj faktorëve gjeopolitik dhe është në gjendje që në mënyrë





kritike t'i qaset strategjive dhe interesave nga perspektiva e rivalit. Ai me sukses ka bërë ndërlidhjen e koncepteve nga të gjitha modulet e studimeve, duke dhënë përgjigje të koncize. Veçanërisht është për t'u përmendur vlerësimi i tij i konceptit të komandës dhe misionit dhe se si ky koncept mund të aplikohet në Ushtrinë e Kosovës në të ardhmen.

Siç thekson raporti përfundimtar i vlerësimit Kolonel Qeriqi po ashtu ka qenë i angazhuar edhe në aktivitet sociale-kulturore e sportive të zhvilluara gjatë studimeve në kolegj duke fituar respekt të lartë në mesin e kolegëve të klasës dhe duke u shndërruar në një lider jozyrtar të oficerëve ndërkombëtarë të kursit. Gjithashtu ai ka shkëlqyer në aktivitetet ekipore, përfshirë këtu garat sportive duke demonstruar tipare profesionale të lidershipit edhe jashtë aktiviteteve akademike.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janë tematikat kryesore të trajtuara gjatë këtyre studimeve dhe si ka vajtur rrjedha e studimeve?*

Kolonel Qeriqi: Gjatë vitit akademik studimet në kolegj kanë qenë të fokusuara në 5 module apo lëndë mësimore si: Lidershipi strategjik, Teoria e luftës dhe strategjisë, Politikat dhe strategjitë kombëtare të sigurisë, Menaxhimi i mbrojtjes, Teoria e strategjive dhe kampanjave në fushëbetejë, Studime regjionale - rasti i Evropës dhe po ashtu kam ndjekur edhe lëndët zgjedhore siç kanë qenë: Negociatat, Ndikimi i zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës në aspektin e sigurisë, Konceptet principet dhe planifikimi i Operacioneve Mbështetëse të Paqes, Zhvillimi ndërkombëtar si shtylla e tretë e sigurisë kombëtare, Elementet e zhvillimit të kapaciteteve të partneritetit.

Siç e përmenda edhe më parë, kemi pasur edhe vizita të shpeshta punë, duke përfshirë Pentagonin, Departamentin e Shtetit dhe institucione të ndryshme relevante, e po ashtu kemi qenë në vizitë edhe në Komandën Amerikane të Paqësorit në Havai. Gjithashtu në kuadër të kolegjit kam qenë i angazhuar edhe në aktivitete socialo-kulturore dhe sportive, qofshin këto aktivitete sportive brenda kolegjit, apo me kolegje të tjera të SHBA për çka kam marrë katër medalje të arta në aktivitetet sportive.



Gazeta "Forca Jonë": *Çka mund të na thoni, më konkretisht, për punimin shkencor dhe mbrojtjen e saj, para profesorëve të Kolegjit, të cilët të kanë vlerësuar si: "oficer i shkëlqyer në çdo aspekt" ?*

Kolonel Qeriqi: Si punim final kam trajtuar temën "NATO dhe Ballkani - Legjitimiteti dhe Roli i NATO-s në Kosovë", ku në një mënyrë jam munduar edhe një herë ta argumentoj rolin e NATO-s në Ballkan dhe në mënyrë të veçantë intervenimin në Kosovë. Duke pasur parasysh se si një kampanjë e suksesshme ushtarake, e cila ka qenë një preventivë për mbrojtjen e popullit të Kosovës, dhe po ashtu kam qenë i fokusuar në bashkëpunimin e UÇK-së dhe NATO-s në një mision të përbashkët për largimin e forcave serbe nga Kosova. Në fund të punimit kam dhënë rekomandime për fushata të tilla, çka është vlerësuar lart nga stafi akademik i kolegjit.

Po ashtu gjatë studimeve në vazhdimësi kemi punuar për të kaluar modulet e lartcekura, çka ka bërë që në fund të moduleve të kemi provimin final me gojë, provim ky i mbajtur para komisionit vlerësues të përbërë nga tre profesorë të fushave si: Lidershipi strategjik, Teoria e luftës dhe strategjisë, Politikat dhe strategjitë kombëtare të sigurisë.

Gazeta "Forca Jonë": *Kolegji i Luftës i Ushtrisë Amerikane ka një traditë të gjatë pune shkencore, në të cilin kolegj, studiojnë edhe oficerë të shumë shteteve të botës, çka konkretisht mund të na thoni?*

Kolonel Qeriqi: Ky këtë kolegj për çdo vit ofron bursa studimi për zyrtarët e lartë të zgjedhur nga vendet aleate dhe vendet e tjera mike. Në vitin akademik 2013-2014, Kosova së bashku me Mauritaninë dhe Sudanin e Jugut, për herë të parë, kanë dërguar oficerë në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara, ku ishin pjesëmarrës 77 oficerë ndërkombëtarë.

Kolegji është themeluar në vitin 1901, ndërsa në vitin 1904 për herë të parë oficerët kanë filluar studimet. Që nga viti 1951, Kolegji i Luftës i Ushtrisë së SHBA-së, gjendet në kazermën "Carlisle" të shtetit Pensilvania, ndërsa që nga viti 1970, në këtë institucion i ka dhënë mundësia e studimit edhe oficerëve ndërkombëtarë.

Rëndësia e këtij niveli të shkollimit dëshmohet më së miri me nivelin e arritjes në karrierë të oficerëve të diplomuar në këtë kolegj. Vetëm nga radhët e studentëve ndërkombëtarë në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë Amerikane kanë diplomuar më se 22 oficerë, që shërbejnë apo kanë shërbyer si shefa të Mbrojtjes apo shefa të Shtabeve të vendeve te tyre.

Gazeta "Forca Jonë": *Njohuritë e fituara në Amerikë, si do t'i praktikoni në Forcat e Armatosura?*

Kolonel Qeriqi: "Besoj se njohuritë e fituara në këtë institucion do të arrijmë t'i përdorim në mënyrën më të mirë dhe efektive me qëllim që ekspertizën e fituar në Kolegjin e Luftës ta përdorim për të ngritur kapacitetet e institucionit tonë, me qëllim që të jemi në gjendje për përballimin e sfidave të së ardhmes duke pasur parasysh ambientin e ri sigurisë në aspektin nacional, regjional dhe global.

Gazeta "ForcaJonë": *Në fund, cili është mesazhi i juaj për pjesëtarët e FSK-së, që studiojnë jashtë Kosovës?*

Kolonel Qeriqi: Mesazhi im për të gjithë oficerët është që të shfrytëzojnë në mënyrë maksimale mundësitë që po na ofrohen për edukim nga vendet partnere, ku niveli i edukimit dhe tradita në fushën e sigurisë është shumë i avancuar, dhe kjo na ndihmon ne për ngritjen e kapaciteteve të mirëfillta të një institucioni të besueshëm, të ndërveprueshëm dhe kompatibil me aleatët dhe doktrinën perëndimore.

Diplomoi gjenerata e gjashtë e kadetëve të FSK-së



Forcës së Sigurisë së Kosovës iu shtuan edhe 5 oficerë të rinj, pra diplomuan 5 kadetë të FSK-së. Me këtë rast në repartet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, më 4 korrik 2014, u mbajt ceremonia solemne me rastin e diplomimit të kadetëve të gjeneratës 2014 të FSK-së.

Në ceremoninë solemne të certifikimit ishin të pranishëm: ministri në detyrë i FSK-së, Agim Çeku; ministri në detyrë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi; zëvendësministri në detyrë i FSK-së, Bejtush Gashi; komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati; komandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT), gjeneralmajor Rrahman Rama; gjeneralët Nazmi Brahimaj, Zymer Halimi, Enver Cikaqi, si dhe Shkëlzen Sylaj, sekretar i përgjithshëm i MFSK-së.



Atifete Jahjaga, presidentja e Republikës së Kosovës, nëpërmjet një letre dërguar komandantit të FSK-së, ka përshëndetur të arriturat e FSK-së, e me këtë rast edhe diplomimin e kadetëve të gjeneratës së gjashtë. Ajo më tutje në letër kishte shkruar se FSK-ja na bën krenar, dhe ne jemi të bindur dhe të vendosur që ta mbështesim dhe ta ngremë me standarde të NATO-s. Në fund presidentja Jahjaga përgëzoi FSK-në për të arriturat dhe njëkohësisht oficerët e rinj, që tani e tutje do t'i shërbejnë vendit dhe sigurisë së tij.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati me këtë rast u shpreh se ndjehet tejet i lumtur dhe njëkohësisht krenar për faktin se tani më Qendra për Studime Universitare(QSU) ka krijuar traditën e përgatitjes së oficerëve dhe se oficerët e rinj, të edukuar dhe të ngritur profesionalisht do t'i bashkohen trupës së oficerëve të FSK-së, për të mbajtur dhe zhvilluar edhe më tutje gatishmërinë operacionale të FSK-së. Më tej gjeneral Kastrati tha se pret nga oficerët e rinj që të jenë shembull gjatë shërbimit dhe të devotshëm ndaj detyrës dhe misionit.

Në ceremoninë e diplomimit të kadetëve të FSK-së, foli edhe gjeneral brigade Steven Altnan, përfaqësues i Gardës Kombëtare të Ajovës(FSK është në partneritet me Gardën Kombëtare të Ajovës që nga viti 2011). Gjenerali Altnan i përgëzoi kadetët për angazhimin e tyre gjatë shkollimit katërvjeçar si dhe iu dëshiroi shëndet e suksese në karrierën e tyre ushtarake. Ai po ashtu u shpreh i lumtur që FSK po ecën drejt zhvillimit të shpejt dhe të sigurt.

Pas leximit të urdhrit për gradim, me të cilin 5 kadetët e FSK-së u graduan me gradën e parë të oficerit atë të nëntogerit, u bë edhe ndarja e certifikatave të cilat oficerëve të rinj ua ndanë; komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe komandanti i QSU-së, kapiten Avni Kiqina.

Ndërsa komandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT), gjeneral major Rrahman Rama, i dorëzoi nëntoger Ismail Hoxhës, çmimin "Kadeti më i mirë i gjeneratës 2014".

Të pesë nëntogerët e FSK-së që sot u diplomuan kanë mbaruar studimet në Qendrën për Studime Universitare dhe në Universitetin Amerikan të Kosovës. Ata sot u graduan dhe u janë caktuar detyrat të cilat do t'i kryejnë në njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.



Kadetë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës vizituan Kazermën "Ushtarët e NATO" në Istog



Në kuadër të Planit për Bashkëpunim Bilateral në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të IOWA-s, një grup i kadetëve dhe instruktorëve të gjuhës angleze të SHBA-s, nga data 18 korrik deri më 9 gusht 2014, po qëndrojnë për një vizitë zyrtare në Kosovë.

Kadetët amerikanë janë nga programi ROTC (Korpusi i Trajnimit të Oficerëve Rezervë) dhe vijnë prej shteteve të ndryshme të Amerikës. Programi i cili po zhvillohet në mes SHBA-s dhe FSK-së, quhet CULP (Kuptimi i Kulturës dhe Përmasimit të Gjuhës Angleze) dhe përbëhet prej dy pjesëve: Pjesës së ligjëratave në gjuhen angleze që realizohet në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, dhe pjesës së vizitave nëpër vendet historike dhe njësiteve të FSK-së.

Qëllimi i këtij programi është thellimi i bashkëpunimit në mes FSK-së dhe ROTC, këmbimi i eksperiencave mes pjesëtarëve të FSK-së dhe kadetëve të ROTC dhe përmasimi i aftësive komunikuese të pjesëtarëve të FSK-së.

Kadetët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 22 dhe 24 korrik vizituan batalionet dhe njësitet e BRSH-së, ndërsa më 25 korrik, vizituan Kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, në Istog.



Gjatë vizitës, kadetët amerikanë, me të arriturat e përgjithshme të BRSH-së, me misionin, me strukturën, me aktivitetet dhe trajnimet e përgjithshme i njoftoi majori Ejup Maqedonci, ushtrues detyre i shefit të Shtabit të BRSH-së, dhe major Valdet Berisha, zëvendëskomandant i Batalionit të Dytë. Me këtë rast, pjesëtarët e Batalionit të Dytë, në ambientet e kazermës, realizuan një demonstrim të përgjithshëm, për nder të kadetëve amerikanë.

Kadetët amerikanë përveç informacioneve bazë të marra nga prezantimet, patën mundësinë të njihen edhe me infrastrukturën e kazermave përkatëse, ku shkëmbyen ide edhe përvojat e dyanshme, në gjuhën angleze, gjë që ka qenë edhe njëra nga qëllimet kryesore të kësaj vizite, bashkëpunimi mes kadetëve dhe instruktorëve të SHBA-s dhe FSK-së.



Ushtrimi "Forca e vendosur 2" testoi aftësitë e Kompanisë 2C të Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë

Në bazë të kalendarit vjetor të stërvitjes së Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), të FSK-së, Kompania 2C ka realizuar trajnimin tremujor që ka filluar më 22 prill 2014 dhe përfunduar më 11 korrik 2014, trajnim ky i cili është përmbyllur me ushtrimin fushor "FORCA E VENDOSUR 2"

Gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e Kompanisë 2C dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht në operacionet ushtarake siç janë patrullimi, prita, kërkim dhe kordon, baza patrulluese, rikonicion të terrenit, reagim në kontakt me armikun, sulm në nivel togu, shkëputje të kontaktit, pika të kontrollit dhe fusha tjera.

Për më tepër ky ushtrim dëshmoj që kjo njësi është përgatitur dhe ka kapacitet të ekzekutojë operacione si njësi e pavarur në terren, për të realizuar qëllimin e komandantit të Batalionit. Po ashtu, gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e kompanisë 2 C janë sfiduar fizikisht me patrullime natën dhe ditën, navigim tokësor dhe lëvizje në terren të thyeshëm me vegjetacion të dendur dhe tema tjera ushtarake, ku treguan vendosmëri dhe moral të lartë për realizimin e misionit .

Gjatë planifikimit dhe zbatimit të këtij ushtrimi fushor çdo detaj ka funksionuar në bazë të Procedurës së Udhëheqjes së Trupave.

Ushtrimi fushor është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Dytë dhe zbatuar në nivel Kompanie nga dt. 08 deri më 10 korrik 2014.

Vlen të theksohet se ky ushtrim është vlerësuar nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) dhe nga ushtarakë të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT) .

Trajnimi tremujor i K2C është pjesë e trajnimit të Kompanive të Batalioneve të RSH në kuadër të rigjenerimit të forcës në njësitë e BRSH-së. Kjo formë e trajnimit është duke u realizuar, në cikle, tash e dy vite në të tri batalionet e BRSH-së. Brenda vitit kalendarik të tria kompanitë e batalioneve kalojnë nëpër këtë trajnim nga tre muaj.







Me rastin e përfundimit të misionit diplomatik

FSK-ja nderoi me medalje Kolonelin James Kott, atashe ushtarak i SHBA-s

Koloneli Kott: "SHBA-të do të vazhdojnë të ecin krah për krah me ju"





Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), më 23 korrik 2014, mbajti ceremoni ushtarake për nderë të Atasheut të mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës(SHBA), kolonelit James Kott, me rastin e përfundimit të misionit të tij, si Atashe i Mbrojtjes i akreditуar në Republikën e Kosovës. Në aktivitetin festiv ishin rreshtuar: Togu Ceremonial i FSK-së, Kuadratet e Njësive të FSK-së, Bendi muzikor i FSK-së ekzekutoi himnet e të dyja vendeve, si dhe në nderim të punës së atasheut amerikan, luajti edhe dy pika artistike me tematikë nga SHBA-ja dhe Kosova.

Në ceremoninë festive morën pjesë; Ambasadorja e SHBA-s, në Republikën e Kosovës, Tracy An Jakobson, Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti gjeneral major Rrahman Rama, sekretari i Përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Zymer Halimi, Gëzim Hazrolli, Enver Cikaqi, Atasheu i radhës i Mbrojtjes, kolonel Chad Butts, atashe ushtarak të akreditуar në Kosovë si dhe oficerë e zyrtarë tjerë të lartë të FSK-së dhe Ambasadës Amerikane në Republikën e Kosovës.

Në fjalën e rastit ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku tha se jemi mbledhur për të falënderuar kolegun shumë të mirë dhe mikun e madh kolonelin James Kott, i cili po përfundon misionin e tij në Kosovë si dhe po përfundon karrierën e tij ushtarake. Marrëdhëniet në mes dy të shteteve, vazhdoi ministri Çeku, ndërtohen bazuar në marrëdhëniet në mes të njerëzve dhe me plot bindje them, shtoi Çeku, se koloneli Kott, ka qenë një përfaqësues shembullor dhe i dalluar i vendit të tij dhe popullit të tij. Me punën e tij me plot përkushtim dhe entuziazëm koloneli Kott ka treguar se është mik i vërtetë dhe i sinqertë i Kosovës dhe qytetarëve të sajë, pohoi ministri i FSK-së.

Duke çmuar lartë punën e atasheut amerikan, ministri Çeku shtoi se: "kontributi i kolonelit Kott do të mbetet përgjithmonë këtu me ne". Kolonel Kott, iu drejtua ministri Agim Çeku, "Gjatë kohës që ju ishit Atashe i Mbrojtjes bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë për FSK dhe FSK-së me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka vazhduar dhe është ngritur në nivelin më të lartë, lidershipi juaj ishte thelbësorë në Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës dhe për të vendosur bazën, dhe përgatitur Forcën e Sigurisë së Kosovës në marrjen e detyrave dhe misionit të ri".

Më tej, ministri Çeku tha: "Ne e vlerësojmë kontributin tuaj në takimet e rregullta me atashetë ushtarak të vendeve të akreditуar në Kosovë, ju gjithashtu keni mbështetur MFSK dhe FSK në operacionet humanitare dhe atyre në asistencë të komuniteteve. Gjithashtu ministri Çeku i shprehu admirim për angazhimin e atasheut amerikan gjatë periudhës së shërbimit 2012-14, duke potencuar: "Deri më tani nga partneriteti me SHBA-të kemi përfituar në 100 programe shkollimi në shkolla amerikane, 122 programe ushtarake përfshirë edhe vizitat e udhëheqësve të lartë, 42 aktivitete në kuadër të programit të partneritetit shtetërorë, 17 aktivitete dhe vizita të DIR-it dhe 11 programe në Qendrën Evropiane për Studime



në fushën e Sigurisë "George Marshall" në Gjermani.

Para se të përfundoj fjalën e tij, ministri Çeku përmendi gjithashtu edhe kontributin frytdhënës në shkollimin e oficerëve të Kosovës, në institucionet ushtarake dhe trajnime në SHBA duke përmendë oficerët që për herë të parë kanë mbaruar Kolegjin e luftës dhe Kolegjin komando shtabor, e gjithashtu edhe Kursin e liderit luftarak, në Qendrën e Stërvitjes dhe Doktrinës, pastaj në ngritjen e Qendrës Rajonale të Ekselencës për Kërkim-Shpëtim si dhe pjesëmarrja e FSK-së në shumë operacione stërvitore rajonale dhe në ato të udhëhequra nga Komanda e Ushtrisë amerikane për Evropë(EUCOM).


Në fund, ministri Agim Çeku në emër të MFSK-së dhe FSK i ndau kolonelit James Kott, medaljen "Shërbim i Shquar", me motivacion: " përkrahje të jashtëzakonshme gjatë shërbimit si zyrtarë i lartë i mbrojtjes, atashe i mbrojtjes, pranë Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, për vizionin dhe angazhimin e tij të jashtëzakonshëm në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë, proces i cili udhëheq transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës".

Koloneli James Kott, Atashe i mbrojtjes i SHBA-ve, në Kosovë pasi pranoj medaljen, pranoj gjithashtu se ndjehet tejet i lumtur dhe i nderuar që Ministria për FSK dhe FSK-ja i kanë bërë këtë ceremoni madhështore me rastin e përfundimit të misionit të tij në vendin tonë. Ai tha gjithashtu se ka emocione të përziera të cilat e ka vështirë që ti kontrolloj apo fsheh. Koloneli Kott tha se ky nder dhe ky shpërblim që iu nda nga ministri Çeku është një prej shpërblimeve më të shtrenjta në karrierën tij ushtarake. Koloneli Kott tha gjithashtu se ky shpërblim paraqet punën e ekipore të anëtarëve ushtarak të ambasadës amerikane në Prishtinë. Koloneli Kott duke përfunduar tha se ndjehet krenar për punën e përbashkët që ka bërë në zhvillimin e vizionit tuaj për Forcat e ardhshme të Armatosura të Kosovës, përmes Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Me ndihmen e ekipit të DIR-it amerikan, ekipi juaj i shkëlqyeshëm ka arrit që të shkruaj raportin zhvillimor dhjetëvjeçar (2014-2024), i cili vizionin tuaj e ka shndërruar në qëllim, e që është një punë shumë e vështirë për një shtet kaq të ri.

Në fund Koloneli Kott tha: "Ju burrat dhe gratë e shkëlqyeshme, pjesëtarë të FSK-së, ju keni arritur shumë për dy vite të kaluara, sepse ju keni arritur që të ndërtoni një forcë profesionale dhe multietnike e aftë dhe e përkushtuar për ta bërë rajonin e Ballkanit më të sigurtë dhe më stabil, Koloneli James Kott, krejt në fund tha: "nuk është e çuditshme që ju mbani ende primatin e institucionit me të besueshëm në vend, sepse me punë ju po e provoni këtë çdo ditë, duke u zotuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ecin krah për krah me ju edhe në të ardhmen.

Koloneli James Kott, që nga viti 2013 ka shërbyer si Atashe i Mbrojtjes pranë Ambasadës së SHBA-s në Prishtinë. Pasardhësi i tij në detyrë është emëruar koloneli Chad Butts.

Marrëveshje bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës(MFSK), më 4 korrik 2014, u nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë, për emërimin e nënkolonel Michael Gierse, këshilltar për çështje logjistike në Ministrinë e FSK-së.

Marrëveshjen e nënshkruan ministri Agim Çeku dhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, dr. Peter Blomeyer.

Në tekstin e marrëveshjes janë definuar fushat konkrete që e intensifikojnë bashkëpunimin në fushën e sigurisë, gjithashtu edhe misionin, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit gjerman që do të jetë i integruar në kuadër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Marrëveshja e sotme e nënshkruar nga ministri Çeku dhe ambasadori Blomeyer është rezultat i bashkëpunimit të dy ministrive dhe në përputhje me marrëveshjet dypalëshe që ka Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës me Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë.

Gjenerali i NATO-s Udo SHNITTKER vizitoi Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin



Në vazhdën e vizitave të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (N-LAT) në Brigadën e Mbështetjes Operacionale (BMO), Regjimentin e Mbrojtjes Civile (RMC) e vizitoi Gjeneral brigade Udo SHNITKER, Shef i N-LAT dhe koloneli Piotr KOLACZ (N-LAT) me detyrë pranë Komandës së Forcave Tokësore.
Komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri së bashku me stafin e tij, e pritën delegacionin nga N-LAT-i, me ç 'rast e informoi me aktivitetet e përgjithshme që Regjimenti është duke i realizuar. Veçanërisht u theksuan aktivitete në fushën e operacioneve të deminimit, eliminimit të mjeteve të pa shpërthyera (EOD-së), kërkim - shpëtimit (KSH), Mbrojtjes Kimike Atomike Biologjike (MKAB), trajnimit, infrastrukturës dhe çështje tjera me interes për zhvillimin e detyrave dhe misionit të njësisë.
Në kuadër të agjendës së vizitës u realizua një demonstrim nga pjesëtarët e RMC-së në prezantimin e shkathtësive të Task Forcës (Kërkim-Shpëtim Urban dhe Ripelim (kërkim -shpëtim në male) i cili u përcollë me interesim të madh nga të pranishmit.
Në përfundim të vizitës, Gjeneral Shnitker shprehu mirënjohjen për Komandantin e Regjimentit të Mbrojtjes Civile dhe gjithë personelin e njësisë së RMO-së për punën, angazhimin dhe profesionalizmin e treguar në operacione dhe aktivitetet tjera.





Zyra për Komunitete në Ministrinë për FSK-në, organizoi seminar, me temën:

Përparimi i integrimit të komuniteteve në FSK

Shefja e Zyrës për Komunitete në MFSK Azemina Çulum, në ambientet e Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, më 09 korrik 2014, para drejtuesve të lartë të MFKS/FSK, si dhe pranisë së ambasadorëve, zëvendës ambasadorëve, atasheve ushtarak të akreditуar në vendin tonë, prezantoi në seminar temë "Përparimi i integrimit të komuniteteve në FSK".
Me këtë rast komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati para të pranishmëve foli për gjendjen, zhvillimet, sukseset si dhe sfidat e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai tha se angazhimi i FSK-së për të realizuar objektivin për të qenë një forcë e dukshme dhe pranë qytetarëve të Kosovës e sidomos komuniteteve pakicë, duke i përkrahur dhe mbështetur në projekte të ndryshme infrastrukturore dhe humanitare e ka bërë FSK-në një forcë të besueshme për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. "Ky imazh ka kontribuar në fushatat tona të suksesshme rekrutuese, ku në secilën fushatë kemi pasur shumë të rinjtë nga komunitetet pakicë të interesuar për t'iu bashkangjitur FSK-së".
Po ashtu komandanti i FSK-së u shpreh i kënaqur me përqindjen e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në FSK "Pjesëtarët e FSK-së nga radhët e komuniteteve pakicë përbëjnë 9.7% të totalit të pjesëtarëve të FSK-së. Padyshim se kjo përqindje e kënaqshme është arritur falë angazhimit të përkushtuar të stafit komandues dhe të gjithë pjesëtarëve të FSK-së në të gjitha nivelet".
Komandanti theksoi faktin e shkollimit aktual të disa kadetëve (të komuniteteve) në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë, ku pas përfundimit të shkollimit do t'i bashkohen FSK-së si oficerë të saj.
Ndërkaq shefja e Zyrës për Komunitete në MFSK, Azemina Çulum, tha se numri i komuniteteve në FSK ka arritur një progres të madh, ku nga 6 pjesëtarë sa ishte numri në 2009 tashmë ka arritur në 200 pjesëtarë nga të gjitha komunitetet, të cilët kanë grada dhe pozita të ndryshme në FSK, si oficerë, nënoficerë dhe ushtarë.
Duke përfshirë këtu edhe 10 femra nga të gjitha komunitetet nga grada e oficerit e deri tek ushtari. Azemina shprehu një falënderim të veçantë për bashkëpunim edhe të kryetarëve të komunave për rekrutimin e një numri sa më të madhe të komuniteteve në FSK. Kurse Florian Qehaja nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë tha se përfaqësimi i komuniteteve në FSK është i kënaqshëm si dhe përgëzoi zyrën për komunitete dhe MFSK/FSK për punën e bërë dhe shtoi se angazhimet për një sukses edhe më të madh nuk duhet të ndalen.
Ai po ashtu propozoi të përforcohet motivimi i punësimit, koncentrimi në rekrutim të jetë në të gjitha regjionet me minoritarë në Kosovë, si dhe të mbahen trajnime për mësimin e gjuhëve që është kusht për një karrierë më të mirë.
Pjesëmarrës në këtë prezantim ishin: ministri i FSK-së Agim Çeku, zëvendësministri Bejtush Gashi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFT-së gjeneral major Rrahman Rama, zëvendëskomandanti i KFT-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë Jan Braathu, zëvendës ambasador, atashe ushtarak, zyrtar të lartë të MFSK-së etj.





Specialistët e FSK-së për Materie të rrezikshme u certifikuan nga instruktorët amerikanët

Në kazermën Evropianët e Rinj të Rexhimentit të Mbrojtjes Civile(RMC), në Pomozotin, përfundoi më 25 korrik 2014, trajnimi tre javor i realizuar nga ekipi Amerikan i EUCOM-it.
Në ceremoninë e certifikimit të 25 pjesëtarëve të Mbrojtjes Kimiko Atomike Biologjike (MKAB) të cilët përfunduan trajnimin " Materiet e rrezikshme- Mostrat dhe pajisjet" të pranishëm ishin; shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, komandanti i RMC-së Kolonel Shaip Haziri, kolonel Skënder Hoxha, kolonel Ilir Qeriqi, nënkolonel Agron Bajrami, i sapoemëruari Atasheu amerikan, kolonel Chad Butts, përfaqësues të ekipit amerikan të instruktorëve, etj.
Pas hapjes së ceremonisë fjalën e mori komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri i cili i falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen, duke u shprehur mjaft i kënaqur me të arriturat e këtij trajnimi: " jam mjaft i kënaqur me suksesin e treguar gjatë këtij trajnimi, pasi që ju përvetësuat edhe më mirë njohuritë e fituara gjatë trajnimeve të kaluara, dhe kërkoj nga ju që këto njohuri të bartën edhe tek të tjerët".
Në gjuhën shqipe pjesëtarët i përshëndeti edhe Atasheu i Mbrojtjes pranë Ambasadës amerikane, kolonel Chad Butts cili i falënderoi të pranishmit që i dhanë mundësinë për ti uruar pjesëtarët " Faleminderit nga ju për këtë mundësi që me është dhënë për t'ju uruar me rastin e diplomimit tuaj, dhe ju faleminderit për punën tuaj gjatë këtij kursi mjaft të vështirë"
Ndërsa në përfundim të ceremonisë para foli edhe Shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri i cili i përgëzoi të gjithë për realizimin me sukses të këtij trajnimi si dhe u shpreh mjaft i kënaqur nga fjalët që i dëgjoi gjatë kësaj ceremonie " është ndjenjë e veçantë të dëgjosh fjalë kaq të mira nga të dy palët si nga komandanti i RMC -së për rëndësinë e trajnimit po ashtu edhe nga instruktorja e ekipit amerikan majorja Araud për mirëpritjen qe u është bërë gjatë qëndrimit të tyre në RMC, gjithashtu kolonel Haziri i falënderoi për trajnimet e shumta që po organizojnë për pjesëtarët e FSK-së "
Në fund të u ndanë certifikata për të gjithë pjesëtarët dhe instruktorët për përfundimin me sukses të trajnimit për Materie të Rrezikshme-Mostrat dhe pajisjet.

Marrëveshje në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, për shkëmbimin të ekspertëve

Sekretari i Përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), dhe Saso Stafanoski, sekretar i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes(MM) të Republikës së Maqedonisë, nënshkruan Memorandum mirëkuptimi lidhur me shkëmbimin e ekspertëve.
Ky memorandum mirëkuptimi paraqet një kornizë për bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të ekspertëve të certifikuar për të kryer trajnime në fushën e çështjeve publike (në tekstin e mëtutjeshëm "trajnerët regjional të certifikuar").
Trajnerët regjional të certifikuar në përputhje me kursin (programin) "Trajno trajnerët" i kryer në Qendrën Regjionale për Çështje Publike (QRÇP) në Shkup, e njohur më parë si Qendra Regjionale e Komunikimit (QRK), me qëllim të trajnimit të personelit-trajnerëve, në fushën e çështjeve publike.
Trajnerët regjional të certifikuar do të jenë në dispozicion të QRÇP në përputhje me planin dhe programin vjetor të aktiviteteve.
Statusi ligjor i trajnerëve të shkëmbyer, që marrin pjesë në aktivitetet në territorin e vendit pritës, do të përcaktohet në përputhje me marrëveshjen NATO/PfP Sofa.
Memorandumi i mirëkuptimit për shkëmbimin e ekspertëve është arritur në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit që ka Ministria e FSK-së me Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë në fushën e mbrojtjes e sigurisë nga vitit 2010. Pastaj duke u bazuar në marrëveshjen ndërmjet shteteve anëtare të Traktatit të Atlantikut të Veriut, lidhur me statusin e forcave të tyre (NATO,SOFA) të vitit 1951, si dhe duke u bazuar në marrëveshjen ndërmjet shteteve anëtare të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, lidhur me statusin e forcave të tyre (PfP SOFA) të Brukselit (19 qershor 1945).

Pjesëtarë të FSK-së certifikohen në kursin e gjuhës turke





Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) më 3 korrik 2014, u mbajt ceremonia e certifikimit të 22 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët përfunduan kursin 9 mujor për mësimin e gjuhës turke.

Në ceremoni morën pjesë: komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi; komandanti i KFOR-it turk në Kosovë, kolonel ZorluTopaloglu; atasheu ushtarak i Turqisë në Prishtinë, kolonel Hasan Aydogdu; kolonel Erdal Dodurga, këshilltar i komandantit të FSK-së; nënkolonel Hasan Hoxha; përfaqësues të NLAT-it në KDS, si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it turk.

Kjo është gjenerata e tretë që përfundoi kursin e gjuhës turke të mbajtur nga instruktorët ushtarak të Turqisë, të planifikuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Qeveria e Turqisë me këtë rast i ka dhuruar KDS-së një laborator për mësimin e gjuhës turke.

Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, duke falënderuar ushtarakët turq për kontributin e tyre për realizimin e kursit të gjuhës turke, ndër të tjera shtoi: "Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes si njësi trajnuese, çdo ditë e më tepër, po kompletohet dhe avancohet me kurse të reja dhe po ofron trajnime për pjesëtarët e FSK-së.

Dega e Gjuhëve të Huaja e cila është në kuadër të Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve, tashmë realizon me sukses edhe kursin e gjuhës angleze dhe kjo flet se ne po avancojmë edhe në këtë drejtim"

Ai, vlerësoi lartë kontributin e instruktorit të gjuhës turke, toger Cihad Turker Doguç i cili u angazhua gjatë tërë kohës me qëllim që të nxjerr më të mirën nga kursi "dhe ja, sot po i shohim rezultatet e punës së përbashkët mësimdhënës -kadet"- tha në fund komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi, i cili njëherësh i dha mirënjohje instruktorit Doguç, për kontributin e dhënë në realizimin me sukses të këtij kursi.

Ndërsa, atasheu ushtarak i Turqisë, kolonel Hasan Aydogdu me këtë rast u shpreh:" Qeveria e Turqisë është e interesuar që ta mbështesë FSK-në, dhe kjo është një dëshmi se ne do të vazhdojmë me mbështetjen tonë edhe në të ardhmen". Koloneli Avdogdu premtoi se kadetët më të suksesshëm të FSK-së do t'i vazhdojnë trajnimet në Turqi.

Në fund u ndanë certifikatat për pjesëmarrësit e kursit, ndërsa me mirënjohje u nderuan ushtarët e dalluar: Ariana Hakaj, Valentina Fana, Fisnik Agolli, Shenasi Gashi dhe Narcis Laqi.

Pjesëtarë të komuniteteve shprehen të kënaqur me kryerjen e kursit të Gjuhës shqipe

Tetari Maksimoviq: 'Njeriu sa gjuhë dinë, aq vlen'



Mësuesja Samire Tahiraj,



Tetari Boban Maksimoviq



Tetar Olivera Svetanoviq



Tetari Sergjan Rakiq



Ushtarja Jovana Jovanoviq



Toger Muamer Hukiq

Gjatë vizitë në ceremoninë e certifikimit për gjuhë shqipe të pjesëtarëve të komuniteteve, shfrytëzuam mundësinë të marrim prononcimin e mësueses, Samire Tahiraj, si dhe prononcimet e disa pjesëtarëve të komunitetit serb dhe boshnjak, pjesëmarrës të këtij kursi.

Mësuesja Samire Tahiraj, ushtare në Brigadën për Mbështetje Operacionale (BMO), për tre muaj, ka mbajtur kursin e gjuhës shqipe (nivelin e parë) me 39 pjesëtarë të komunitetit serb dhe boshnjak, në Batalionin e Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Gjilan. Për angazhimin e saj rreth realizimit të këtij kursi ajo ndër të tjera u shpreh: "Mbajtja e kursit, për mua ka qenë punë me përgjegjësi, por tani ndihem krenare falë suksesit final dhe i falënderoj të gjithë pjesëtarët e komuniteteve për interesimin dhe angazhimin e tyre të madh për të mësuar gjuhën shqipe. Ajo që më gëzon më shumë është suksesi i kursistëve, të cilët tani më pothuajse të gjithë mund të komunikojnë në gjuhën shqipe pa probleme". Ajo njëherësh potencoi edhe sjelljen e mirë dhe korrekte të pjesëtarëve të komuniteteve, e cila sigurisht që ka ndikuar edhe në arritjen e këtij rezultati për të cilin ajo ndjehet e lumtur.

Ndërsa, **tetari Boban Maksimoviq** (intervista u zhvillu në gjuhën shqipe), për rëndësinë e këtij kursi u shpreh: "Mbajtja e këtij kursi për neve ka qenë shumë i rëndësishëm, jo vetëm për mua, por edhe për të gjithë pjesëtarët e tjerë të FSK-së, nga radhët e komuniteteve. Ne gjatë këtij cikli kemi arritur rezultate të rëndësishme. Unë kam pasur njohuri edhe më parë, para mbajtjes së kursit të gjuhës shqipe, sepse kam shërbyer në radhët e TMK-së dhe tani në FSK, por kursi ka qenë shumë i dobishëm, sepse tani pa kurrfarë kompleksi komunikojë në gjuhën shqipe, dhe kjo është shumë më rëndësi për mua. Unë i falënderoj shumë kolegët shqiptarë të cilët na ndihmojnë gjithnjë.

Tetari Maksimoviq, potencoi maksimën se "njeriu sa gjuhë dinë, aq vlen". Ai shprehu mendimin e tij dhe të kolegëve, se ka nevojë të vazhdohet me organizimin e kurseve të niveleve të tjera. Po ashtu nuk munguan nga ana e tij as lëvdatat për mësuesen Samire Tahiraj të cilës ia dedikon meritat për mësimin më lehtësi të gjuhës shqipe.

"Unë jam **tetar Olivera Svetanoviq,** pjesëtare e FSK-së, punoj në Batalionin e Parë për Reagim të Shpejtë në Gjilan. Për mua organizimi i këtij kursi ka qenë i mirëpritur, pasi që unë e kam kuptuar gjuhën shqipe edhe më herët, por kam pasur vështirësi të komunikoj. Tani pas vijimit të kursit, falë edhe mbështetjes së kolegëve të mi shqiptarë unë komunikoj lirshëm në gjuhën shqipe me kolegët e punës"-tha në fund tetar Stefanoviq.

Komunikimi në mes vete sjellë siguri në të folur na thotë **tetari Sergjan Rakiq** nga Komuna e Kllokotit, Ai është i sistemuar në Kompaninë 1A të Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejt të FSK-së në Gjilan. Tetari Rakiq, më parë, ka punuar në TMK dhe tani në FSK.

Tetari Rakiq, thotë: "Unë edhe më parë kam punuar në TMK dhe tani në FSK. Mësimi i gjuhës shqipe është shumë i rëndësishëm për mua. Mbajtjen e kursit e kam pritur me shumë interesim, sepse unë edhe më parë kam komunikuar, por jo në këtë nivel si tani. Kursin e kam ndjekur me shumë dëshirë, sepse më ka ndihmuar të komunikoj lirshëm në gjuhën shqipe. Unë kam përfituar shumë me kryerjen e këtij kursi, se tani kam një siguri të madhe jo vetëm në të folur por edhe në të shkruar dhe lexuar. Shpresoj qe ky kurs të vazhdojë edhe me nivelin e dytë dhe të komunikojmë me shumë në mes vete, se kështu e mësojmë ma lehtë gjuhën e njeri-tjetrit.

Ushtarja Jovana Jovanoviq, duke u shprehur në gjuhën shqipe tha : "Unë punoj në Njësinë 1C të BRSH-së. Më përpara pak, shumë pak, kam ditur të flas shqip. Ky kurs me ka ndihmuar mjaft, por unë dëshiroj ta mësoj edhe më shumë gjuhën shqipe"- tha në fund ushtarja Jovanoviq.

Toger Muamer Hukiq është pjesëtarë i Batalionit të Dytë të BRSH-së në Istog. Ai e shef shumë të nevojshëm organizimin e niveleve të tjera të këtij kursi. Ai thotë: "Unë punoj në Kompaninë Mbështetëse të BRSH-së në Istog. Kryerja e nivelit të parë të kursit të gjuhës shqipe, për mua ka qenë i rëndësishëm dhe këtë e kam pritur me dëshirë. Unë kam arrit që deri 60 % ta mësoj gjuhën dhe lirisht tani komunikoj në gjuhën shqipe pa vështirësi, por për të qenë me i sigurt në të shprehur e ndiej nevojën e vazhdimit të nivelit të dytë".

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 27 • Shtator 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

FSK-ja organizoi ceremoni lamtumirëse për komandantin e KFOR-it gjeneralin Salvatore Farina





Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), në Prishtinë u mbajt ceremonia lamtumireshe për nderë të komandantit të KFOR-it, gjeneral major Salvatore Farina, me rastin e përfundimit të misionit të tij në Republikën e Kosovës. Gjeneral Farina u përcoll me nderime ushtarake nga Togu Ceremonial i FSK-së, Kuadratet e Njësive të FSK-së dhe Trupa muzikore e FSK-së.

Në fjalën e tij ministri Agim Çeku tha se gjenerali Farina ishte një komandant i vërtetë, profesionist i respektuar dhe përfaqësues shembullore i Forcave të Armatosura Italiane. Ai tha se gjeneral Farina, me punën e tij të devotshme dhe të përkushtuar, ka dëshmuar që është një mik i vërtetë i Kosovës dhe popullit të saj.

Çeku e çmoi lart edhe kontributin e gjeneralit italian për realizimin e projekteve të ndryshme.

"Si komandant i KFOR-it, bashkëpunimi i juaj ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme edhe në implementimin e suksesshëm të një numri të projekteve dhe iniciativave të Kosovës", tha ai.

Ministri Çeku, në emër të Ministrisë dhe FSK-së ia ndau gjeneral majorit Salvatore Farina medaljen "Shërbim i Shquar".

"Për mbështetjen e tij të jashtëzakonshme gjatë shërbimit si komandant i KFOR-it në Prishtinë. Vizioni strategjik, lidershipi dhe përkushtimi i tij ishin thelbësor në ndihmën e ofruar Forcës së Sigurisë së Kosovës në zhvillimin e kapaciteteve të saj", thuhet në motivacionin e medaljes.

Gjeneral major Salvatore Farina pasi pranoi medaljen "Shërbim i Shquar" tha që kam pak emocione, por me një kënaqësi të veçantë e marrë këtë shpërblim. Unë do të doja të falënderojë për konsideratën tuaj. Ky nuk është vetëm një shpërblim për mua, por kjo mirënjohje është për punën e madhe të bashkëpunimit me KFOR-in, Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT), MFSK-në dhe ushtarët e FSK-së. "Kam qenë i bekuar dhe ka qenë privilegj për mua të udhëheqë këtë forcë profesionale dhe të aftë, por në të njëjtën kohë të punojë krah për krah me këta profesionistë të mëdhenj, me liderë politikë dhe ushtarak, po ashtu edhe me këta ushtarë të rijnë para meje".

Në fund të fjalës së tij, ministri Çeku, falënderoi edhe të gjitha shtetet që kanë kontribuar me dërgimin e trupave të tyre në misionin e KFOR-it. "Së bashku kemi bërë hapa të mëdhenj për ta fuqizuar sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë. Përpjekjet tona kanë bërë që Kosova të zhvillohet drejtë qëllimit të saj të integrimeve Euro-Atlantike".

Në ceremoninë lamtumirës për gjeneral Farinën morën pjesë: ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës Shpend Maxhuni, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral major Rrahman Rama, drejtori i AKI-së, Bashkim Smaka, sekretari i Përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, ambasadori i Italisë në Kosovë Andreas Ferrarese, gjeneral dhe oficerë të KFOR-it, atashe ushtarak, oficerë dhe zyrtarë të lartë të MFSK dhe FSK.

Gjeneral major Salvatore Farina ishte emëruar komandant i KFOR-it në Kosovë në vitin 2013. Pasardhës i tij në këtë detyrë është emëruar gjeneral major Francesko Paolo Figliuolo.

Gjenerali Farina nderohet me medaljen "Shërbim i Shquar"

Me motivacionin për mbështetje të jashtëzakonshme për FSK-në gjatë shërbimit si komandant i KFOR-it, ministri i FSK-së, Agim Çeku, e nderoi gjeneralmajorin Selvatore Farina me medaljen "Shërbim i Shquar".

Pas pranimit të medaljes, gjeneral Farina ka deklaruar se me një kënaqësi të veçantë e merr këtë shpërblim. "Do të doja të ju falënderoja për konsideratën tuaj. Ky nuk është vetëm një shpërblim për mua, por kjo mirënjohje është për punën e madhe të bashkëpunimit me KFOR-in, Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT), MFSK-në dhe ushtarët e FSK-së", ka deklaruar Farina.

Pjesëmarrje e dinjitetshme e FSK-së në ushtrimin e përbashkët "Përgjigjja e Menjëhershme 2014" mbajtur në Sllloveni

Një Kontingjent i FSK-së, prej 17-30 gusht 2014, mori pjesë në ushtrimin fushor të koduar "Përgjigjja e menjëhershme 2014" mbajtur në Republikën e Sllovenisë, me moton "Forca përmes partneritetit". Në ushtrimin e përbashkët, morën pjesë edhe njësitë ushtarake nga: Sllovenia, Kroacia, SHBA, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Danimarka, Anglia, Hungaria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i zi.

Kontingjent i FSK-së, përbehej prej tri ekipeve të specializuara, Kërkim-Shpëtim, Deminim dhe Mjekësi, me gjithsej 24 pjesëtarë, ushtrimi u mbajt në tri qytete: Postojna, Vipava dhe Mahnice në Republikën e Sllovenisë.

Gjatë mbajtjes së trajnimit, kontingjenti i FSK-së tregoi një nivel të lartë të profesionalizmit, pati koordinim dhe bashkëpunim të mirë me të gjitha ushtritë e vendeve pjesëmarrëse.

Përveç ushtrimeve në terren pjesëtarët e FSK-së, së bashku edhe me pjesëtarët e ushtrive të vendeve tjera pjesëmarrëse, janë certifikuar për angazhim edhe në pjesën akademike, ku kanë ligjëruar tema të ndryshme që kishin të bëjnë më reagimet në fatkeqësi.

Sipas skenarit njësitet e ushtrive pjesëmarrëse; trajnimet i mbajtën në deminim, kërkim-shpëtim urban dhe mjekësi.

Demonstrimi i parë është mbajtur për deminim, ku njësitet ishin të kombinuara me pjesëtarë të



shteteve pjesëmarrëse.

Gjatë demonstrimit të dytë u bë intervenimi në kërkim-shpëtim urban, intervenimi në një ndërtese banimi për shpëtimin e banorëve të mbetur në të. Njësiti i Kërkim-Shpëtimit Urban i FSK-së tregoi shkathtësi dhe profesionalizëm në shpëtimin e të lënduarve përmes zbritjes me litarë nga ndërtesa e bllokuar.

Ndërsa, demonstrimi i tretë u realizua nga ekipet ushtarake mjekësore, të cilat sipas skenarit intervenuan në dhënien e ndihmës së parë të lënduarve nga gërmadhat dhe evakuimin e tyre me autoambulanca.

Trajnimet e ushtrive pjesëmarrëse nga afër i përcolli edhe kryeministri i Sllovenisë, përfaqësues të ushtrive pjesëmarrëse dhe zëvendës komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama së bashku me një delegacion të FSK-së, i cili vlerësoi lartë profesionalizimin dhe bashkëpunimin shumë të mirë të FSK-së, me të gjitha ushtritë pjesëmarrës në trajnim.

(Vijon në faqen 2)

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti një delegacion gjeneralësh të SHBA-ve



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 1 gusht 2014, priti në ambientet e kazermës "Adem Jashari" në Komandën e Forcave Tokësore (KFT), në Prishtinë, një delegacion prej 20 gjeneralësh dhe admiralësh të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të prirë nga admirali Harold Gehan dhe Mr. Clyde Manning, (organizuar nga Ambasada Amerikane, në Prishtinë).

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati falënderoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) për ndihmën e vazhdueshme që po japin në ngritjen profesionale të FSK-së, për bashkëpunimin e mirë që ka edhe me Gardën Kombëtare të IOWA-s.

Gjeneral Kastrati, më pastaj, e njoftoi delegacionin e gjeneralëve amerikanë për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, themelimin e saj, shkollimin e kuadrove brenda dhe jashtë vendit, trajnimet e përgjithshme, realizimin e shumë projekteve humanitare, që janë në shërbim për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve në Kosovë, për bashkëpunimin rajonal dhe për çështje të tjera të përgjithshëm.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati foli edhe për rekomandimet e dala nga DIRI dhe grupet punuese të FSK-së, për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë si dhe për implementim e saj në të ardhmen.

Në fund, gjeneral Kastrati u përgjigj në shumë pyetje, të cilat i parashtruan gjeneralët amerikanë, që kishin të bënin me rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, strukturën organizative të Ministrisë dhe FSK-së, si dhe bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtar.

Në këtë takimin, morën pjesë edhe zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi dhe kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim në MFSK.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ligjëroi para kadetëve të SHBA-s dhe FSK-së





Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e akredituar në Prishtinë, znj. Tracey Ann Jacobson, më 1 gusht, vizitoi kazermën "Skënderbeu"të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, e cila u prit nga komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi me bashkëpunëtorë.

Me këtë rast, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi e njoftoi ambasadoren Jacobson me të arriturat e KDS-së, si dhe për rrjedhën e trajnimit të përbashkët të kadetëve amerikanë dhe pjesëtarëve të FSK-së, trajnim ky, i cili është duke u realizuar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh mes SHBA-s dhe Kosovës.

Ambasadorja Jacobson së bashku me gjeneral Cikaqin, më pastaj, vizituan kadetët amerikanë dhe ata të FSK-së, ku biseduan për përshtypjet e tyre gjatë qëndrimit të përbashkët, aktiviteteve dhe angazhimeve të tyre, si dhe mbajti një ligjëratë para kadetëve amerikanë dhe pjesëtarëve të FSK-së.

Ajo tha se ndjehet e lumtur që gjendet në mesin pjesëtarëve të FSK-së dhe kadetëve amerikanë, në këtë rrugëtim të përbashkët dhe falënderoj komandantin e KDS-së, për pritjen dhe krijimin e mundësive për kadetët që do të jetë një përvojë e mirë për të dyja palët që të shkëmbejnë përvoja në mes veti

Ndërsa, gjeneral Cikaqi falënderoi ambasadoren Jacobson, për bashkëpunimin dhe ndihmën e vazhdueshme të SHBA, për të shtuar, se: "vizita e kadetëve amerikanë në FSK, është një përvojë e mirë për pjesëtarët e FSK-së, të cilët bashkërisht janë duke zhvilluar aktivitete të ndryshme, si mbajtjen e ligjëratave në klasë, vizita në qytete të Kosovës, aktivitete sportive etj. Kjo do të jetë një përvojë e mirë për pjesëtarët tanë, por edhe për kadetët amerikanë"- tha në fund, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi.

Pjesëmarrje e dinjitetshme e FSK-së në ushtrimin e përbashkët "Përgjigjja e Menjëhershme 2014" mbajtur në Sllloveni

Vijon nga faqja 1

Me këtë rast gjeneral Rama ka përgëzuar ushtarët e FSK-së, për trajnimin dhe demonstrimin e lartë në ushtrimin "Përgjigja e menjëhershme 2014".

Ekipet e FSK-së, kanë treguar profesionalizëm edhe në operacionet e Deminimit dhe Mjekësi.

Demonstrimi 1 - lokacioni i parë kishte një prezantim për EOD, Kërkim Shpëtim dhe Evakuim Mjekësor, ku njësitë intervenuese janë te kombinuara me pjesëtarë te shteteve pjesëmarrëse.

Demonstrimi 2 - lokacioni i dytë pati prezantim lidhur me shpëtimin e të bllokuarve në kulmin e një ndërtese, ku se pari do të bëhet një evakuim me helikopter, dhe pastaj kërkim shpëtimi urban i FSK-së do të bëjë një zbritje me lese me litarë të një personi të lënduar nga kulmi i ndërtesës. Komandanti i kontingjentit ka bërë prezantimin deri sa Njësia e Kërkim Shpëtimit Urban të FSK-së po kryente operacionin e kërkim shpëtimit nga lartësia e një ndërtese me ndihmën e litarëve dhe lesës.

Përveç ushtrimeve në terren pjesëtarët e FSK-së së bashku më ushtritë e vendeve tjera janë certifikuar për pjesëmarrje dhe angazhim edhe në pjesën akademike ku janë ligjëruar tema të ndryshme që kishin të bëjnë më reagimet në fatkeqësi.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Një Kosovë pa mina, objektiv i deminerëve të FSK-së

Deminerët e FSK-së kanë pastruar mbi 1,038,612 metra katrorë fusha të minuara



Edhe pse shumë nga fushat e njohura si të rrezikshme janë pastruar, ende në Kosovë ekzistojnë zona të rrezikshme nga minat apo mjetet tjera eksplozive të pashpërthyera, na thotë Ahmet Sallova, shef i Sektorit për Deminim të EOD-së, në Ministrinë për FSK-në.
Minat dhe municionet e pashpërthyera eksplozive do të vazhdojnë të gjenden në Republikën e Kosovës edhe për shumë vite.
Këtë e bazoj, në faktin se njësitet e FSK-së, edhe sot, gjatë aktiviteteve të tyre në operacione pastrimi, ndeshen me mjete të ndryshme eksplozive, të cilat datojnë që nga Lufta e Dytë Botërore.
Prania e vazhdueshme e zonave të minuara dhe mjeteve tjera të pashpërthyera në zonat e afektuar nga to, nuk përbën vetëm një rrezik për jetën e banorëve por vështirëson edhe gjendjen ekonomike të tyre, për shkak të mospërdorimit të këtyre tokave bujqësore dhe zonave malore.
Evitimi i rrezikut nga minat dhe mjetet eksploziveve të pashpërthyera (MEP) është një parakusht për rindërtimin e vendit dhe resurseve të saj natyrore dhe ekonomike.
Pa zgjidhjen e problemit të minave dhe MEP nuk është e mundur një jetë e qëndrueshme dhe e sigurt.
Njësitë e deminimit të FSK-së, janë duke rivendosur dhe krijuar një mjedis të sigurt në fushat e tanishme të rrezikuara, duke mundësuar zhvillimin e jetës normale.
Njësitë e FSK-së, që nga fillimi i operacioneve të deminimit, në vitin 2010, kanë pastruar mbi 1,038,612 metra katrorë, dhe kanë zbuluar dhe shkatërruar 1259 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera.
Këto rezultate na bëjnë krenar për punën e shkëlqyeshme të deminerëve të FSK-së, të cilët me angazhimin maksimal kanë bërë të mundur shpëtimin e shumë jetë njerëzish dhe njëkohësisht shfrytëzimin e një numri të madh të tokave punuese.
Përveç njësive që zhvillojnë operacionet e deminimit humanitar në terren, FSK-ja ka edhe dy njësi të cilat bëjnë kujdestari 24 orë në ditë, gjatë 7 ditëve të javës, të gatshëm për intervenime, në rastet kur qytetarët hasin në mjete të ndryshme eksplozive dhe lajmërojnë njësitet e FSK-së, për largimin e tyre.
Që nga fillimi i këtyre operacioneve FSK-ja, ka intervenuar në 1344 raste dhe ka demoluar 2166 mjete të ndryshme eksplozive.





Në tërësi, që nga viti 1999 janë pastruar 48,676, 912 metra katrorë, ku janë gjetur 86,896 mina dhe mjete eksplozive të pashpërthyera nga të gjitha organizatat që kanë punuar në Kosovë në pastrimin e minave dhe mjeteve eksplozive të pashpërthyera.
Njësitet e deminimit të FSK-së, gjatë këtij viti, po punojnë në Parkun e Ferizajt në Luzhnicë, në kazermën "Skënderbeu" të FSK-së, në Ferizaj, në Goranc dhe në Nivokaz.
Gjatë vitit 2013, është bërë hulumtimi në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe bazuar në këtë hulumtim, ku janë intervistuar banorët lokal të vendeve të afektuar nga minat dhe mjetet e pashpërthyera, ka rezultuar që në vendin tonë ekzistojnë ende 135 zona të prekura nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera, që përkthyer në metra katrorë janë, 10, 295, 500 metra katrorë.
Për të pastruar të gjitha zonat e rrezikshme, me kapacitetet e tanishme, duhen më shumë se dhjet vite punë.
FSK ka bërë një punë të madhe edhe me vetëdijesimin e gjeneratave të reja për rrezikun nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera, në mënyrë që të gjithë qytetarët të vetëdijesohen dhe shmangin pasojat fatale të cilat mund të sjellin minat dhe mjetet e pashpërthyera.
Që nga koha e luftës, 116 persona janë vrarë si pasojë e minave ose mjeteve eksplozive dhe 458 janë lënduar.

FSK-ja dhuroi mbi 400 doza gjak gjatë muajit gusht

Në Forcën e Sigurisë së Kosovës ka përfunduar aksioni 10 ditor i dhurimit vullnetar të gjakut, i realizuar në të gjitha njësitë e FSK-së, nga 4-14 gusht 2014.







Në organizim të Departamentit të Mjekësisë të FSK-së, Departamentit për Bashkëpunim Civil-Ushtarak (BCU) dhe në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK), edhe këtë vit, u krye aksioni humanitar i dhurimit të gjakut në FSK, me moton "dhuro gjak shpëto jetë". Aksioni humanitar ka filluar më 4 gusht në Ministrinë e FSK-së dhe është mbajtur në të gjitha njësitet dhe kazermat e FSK-së. Aksionin e kanë kryer infermieret e QKTGJK në bashkëpunim me infermierët e Batalionit të Mjekësisë të FSK-së.
FSK-ja ka një traditë të organizimit dhe të dhurimit humanitar të gjakut, dhe ky është viti i gjashtë që FSK-ja, po dhuron gjak. Pjesëtarët e FSK-së, jo vetëm gjatë organizimit të aksioneve të rregullta, por ata po dhurojnë gjak edhe jashtë këtyre organizimeve, dhe janë gjithmonë të gatshëm për dhurimin e gjakut edhe në të ardhmen, çdo herë, për nevojat e pacientëve që kanë nevojë për gjak
Sipas stafit udhëheqës të QKTGJ-së, pjesëtarët e FSK-së janë donatorë të rregullt të dhurimit të gjakut dhe se çdoherë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni.
Menaxheri i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës, Fadil Mahmuti shtoi: "Pjesëtarët e FSK-së janë donatorët më të rregullt të gjakut, dhe se çdo herë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni. FSK-ja i ka dhënë përkrahje maksimale aksionit për dhurimin e gjakut, që kanë qenë shembulli më i mirë prej të gjithëve, ku numri i dhuruesve po vazhdon të shtohet. Edhe për ne gjithmonë është një kënaqësi e veçantë, kur ndodhemi



në mesin e ushtarëve dhe oficerëve të FSK-së, të cilët presin në radhë për dhurimin e gjakut".
Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut ka përfunduar më 14 gusht 2014. Këtë vit, FSK-ja ka dhuruar mbi 400 doza gjak, e që do të jenë në shërbim të gjithë atyre që kanë nevojë për gjak.
Ndërsa, koloneli Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim në MFSK, është dhurues i rregullt i gjakut, u shpreh: "FSK-ja ka një traditë të organizimit të aksioneve humanitare për dhurimin e gjakut edhe para themelimit të FSK-së. Shumë pjesëtarë të FSK-së, janë shembull për dhurimin e gjakut, me motën për shpëtimin e atyre që kanë nevojë më së shumti për gjak".
Komandanti i Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së, nënkolonel Hamide Osaj, po ashtu ka vlerësuar lartë aktin e pjesëtarëve të FSK-së në aksionin për dhurimin e gjakut, të cilit i janë përgjigjur 410 pjesëtarë.

Intervistë me nënkolonel Fidaim Elshanin, komandant i Kontingjentit të FSK-së, i cili mori pjesë në ushtrimin "Përgjigja e Menjëhershme" në Sllloveni

FSK-ja dëshmoi se është e përgatitur profesionalisht të marrë pjesë në ushtrime të përbashkëta me vendet e NATO-s

Gjenerali Miha Škerbinc: Arritje e këtij ushtrimi ishte pjesëmarrja e FSK-së, për herë të parë në një ushtrim të përbashkët të këtij niveli me vendet e NATO-s. Ky ishte njëri prej sukseseve të këtij ushtrimi



Nënkolonel Fidaim Elshani

Gazeta "Forca Jonë": *Zotëri nënkolonel, në ushtrimin "Përgjigja e Menjëhershme 2014" e mbajtur ditë më parë, në Republikën e Sllovenisë, mori pjesë edhe një kontingjent i FSK-së, ju si komandant i saj çfarë mund të thoni për këtë?*

Nënkolonel Fidaim Elshani: Dizajnimi i ushtrimit dhe udhëheqja është bërë nga Komanda Amerikane për Evropë në bashkëpunim me shtetet tjera pjesëmarrëse, ndërsa shtrirja e ushtrimit ishte në territoret e Sllovenisë dhe të Kroacisë. Organizimi i ushtrimit ishte i ndarë në dy pjesë, pjesa e Ushtrimit të Postë Komandës, dhe pjesa e Ushtrimi Fushor (UF). Forca e Sigurisë së Kosovës ka marrë pjesë në ushtrimin "Përgjigja e Menjëhershme 2014" me një kontingjent prej 24 pjesëtarëve, të barabartë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të 11 ushtrive të shteteve pjesëmarrës, si: Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Shqipëria, SHBA, Mbretëria e Bashkuar, të udhëhequr nga Komanda Amerikane për Evropë, EUCOM. Ushtrimi është mbajtur në territorin e Sllovenisë dhe të Kroacisë. Niveli i ushtrimit ishte niveli Brigade, përbëhej prej dy brigadave, njëra në Sllloveni (Brigada Manovruese) dhe tjetra në Kroaci (Brigada e Mbështetjes-Logjistike). Ushtrimi ishte i ndarë në dy pjesë; Ushtrimi i Postë Komandës dhe Ushtrimi Fushor. Ndërsa FSK-ja ishte pjesë e ushtrimit fushor e cila po ashtu ishte e ndarë në dy pjesë: pjesa akademike dhe ushtrimi në terren. Kontingjenti i FSK-së mori pjesë me tri njësi të specializuara intervenuese të pajisur me pajisjet personale dhe kolektive, si: Njësia e Kërkim- Shpëtimit Urban (KSHU), Deminimit (EOD) dhe ajo e Mjekësisë.



Gazeta "Forca Jonë": *Cila ishte rëndësia e pjesëmarrjes së FSK-së, në ushtrim fushor "Përgjigja e Menjëhershme 2014" mbajtur në Sllloveni?*

Nënkolonel Fidaim Elshani: Vet pjesëmarrja e kontingjentit të FSK-së, në mesin e 11 ushtrive të rajonit dhe më gjerë, fletë mjaft. Por, ajo që na bënë neve të jemi të kënaqur, është niveli i njëjtë profesional me ushtritë pjesëmarrëse, kjo u dëshmua edhe gjatë ushtrimit dyjavore "Përgjigja e Menjëhershme 2014". Për neve shumë më e rëndësishme ishte vetë pjesëmarrja, bashkëveprimi së bashku me të gjitha ushtritë pjesëmarrëse, realizimin e një qëllimi të përbashkët; fitimin dhe ndërtimin e besimit të përbashkët dhe të ndërsjellë me të gjithë pjesëmarrësit në ushtrim.

Gazeta "Forca Jonë": *Cila është e veçanta e këtij ushtrimi?*

Nënkolonel Fidaim Elshani: Si më e veçanta e këtij ushtrimi ishte pjesëmarrja e FSK-së, për herë të parë përkrah shteteve të NATO-s, në një nivel të këtillë të përfaqësimit, ku jo vetëm që kemi vepruar së bashku me shtetet tjera, por me angazhimin dhe performancën tonë kemi treguar se ne kemi kapacitetin dhe potencialin njerëzor për të vepruar duke ofruar mbështetje të duhur në reagime ndaj kërcënimeve dhe fatkeqësive.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili ka qenë roli i FSK-së në këtë ushtrim?*

Nënkolonel Fidaim Elshani: FSK në këtë ushtrim është paraqitur me një kontingjent në përbërje prej 24 pjesëtarësh dhe dy automjete, përfshirë njësi të specializuara të Kërkim-Shpëtimit (KSH), Deminimit (EOD) dhe Mjekësisë, si dhe me staf planifikues me oficerë të fushave nga: G3, G4, G6, G9.

Roli i FSK-së ka qenë që të veprojë përkrahë shteteve të tjera në fusha të caktuara, ku na janë dhënë detyra konkrete, si në kontrollin e ushtrimit kemi pasur dy oficerë, në komandimin e ushtrimit në QOE kemi pasur katër oficerë, në terren në intervenime kemi pasur njësitë reaguese të kombinuara me pjesëtarë të shteteve tjera.



Vlen të theksohet se gjithashtu ne kemi qenë pjesë e planifikimit aktiv në të tri konferencat planifikuese, ku na janë besuar detyra siç është për shembull, përgatitje e skenarit të ushtrimit dhe përgatitja e listës së ngjarjeve dhe incidenteve kryesore.

Vendet pjesëmarrëse kanë vendosur që angazhimet dhe reagimet në intervenime të bëhen të përbashkëta, njësitë intervenuese të KSH, EOD dhe Mjekësisë , gjatë intervenimeve kanë qenë të kombinuara me pjesëtarë të shteteve pjesëmarrëse, duke demonstruar kështu integritet, vendosmëri dhe procedura të njëjta në përballje me ngjarjet dhe rreziqet që kanosin jetët dhe pasuritë e qytetarëve.

Dita e vizitorëve (DVD), është realizuar sipas planit më 27 gusht, ku kanë marrë pjesë shumë institucione të larta të Sllovenisë, përfshirë këtu Kryeministrin e Sllovenisë si dhe përfaqësues nga institucione ndërkombëtare.

Gazeta "Forca Jonë": *Çfarë ka përfituar FSK-ja, nga ky ushtrim?*

Nënkolonel Fidaim Elshani: Nëse mund ta quaj kështu, ky është "një thyerje akulli" dhe një fillim i mbarë për të qenë pjesë e ngjarjeve të këtilla. Ne jo se nuk kemi qenë të përkrahur nga shtetet mike të cilat na kanë ndihmuar në rrugëtimin tonë deri këtu, dhe na kanë përkrahur që të jemi pjesë e ngjarjeve të ndryshme edhe në të kaluarën e afërt, por, me pjesëmarrjen tonë, ne, edhe një herë kemi dëshmuar se investimet e aleatëve tanë në ngritjen, zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së kanë qenë me vend dhe ia ka vlejtur. Me profesionalizmin e treguar në këtë ushtrim kemi ndërtuar, apo më mirë të themi, e kemi përforcuar besimin se FSK-ja është një forcë në të cilën mund të llogaritet se prodhon siguri dhe ka potencial për të vepruar përkrah shteteve të NATO-s.

Ka qenë një përvojë e mirë, ku janë shkëmbyer eksperienca me pjesëmarrësit nga vende dhe ushtri të ndryshme. Ajo që do të shtoja, është se procedurat dhe standardet e përdorura në këtë ushtrim kanë qenë të njohura dhe lehtë të kapshme për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, që edhe dëshmon se trajnimet që kanë ndjekur pjesëtarët tanë janë të nivelit dhe standardeve të vendeve të NATO-s.

Gazeta "Forca Jonë": *Zotëri nënkolonel, pas pjesëmarrjes në këtë ushtrim në Sllloveni, a është FSK-ja e gatshme dhe profesionalisht e përgatitur për pjesëmarrje në ushtrime ndërkombëtare?*

Nënkolonel Fidaim Elshani: Ne jemi të përgatitur plotësisht dhe profesionalisht për të marrë pjesë në ushtrime të tilla me shtetet e NATO-s, këtë e dëshmoi FSK-ja edhe në ushtrimin e mbajtur në Sllloveni, përkrahë shteteve të NATO-s, si SHBA-ve, Kroacisë, Sllovenisë, etj. Këtë e potencoi edhe vet, Gjenerali Miha Škerbinc, gjatë fjalimit të tij përmbyllës, ku ndër të tjera, tha: "Si të arritura të këtij ushtrimi theksoj rëndësinë e pjesëmarrjes së FSK-së për herë të parë në një ushtrim të përbashkët të këtij niveli me vendet e NATO-s, duke e veçuar si njërin prej sukseseve të këtij ushtrimi". Ndërsa komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) dhe gjeneralmajor Rrahman Rama, i cili e përcolli nga afër ushtrimin e kontingjentit të FSK-së, i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për punën profesionale dhe angazhimin e tyre gjatë ushtrimit.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është mesazhi juaj?*

Nënkolonel Fidaim Elshani: Investimet në trajnimin dhe arsimimin e pjesëtarëve të FSK-së, në pajisjen e forcës me mjete personale dhe kolektive, janë investime në përballje me sfidat e kohës, çelës që hapë dyert e rrugëtimit përkrah vendeve të zhvilluara, është garanci se Kosova nuk do të jetë vetëm konsumues i sigurisë, por do të jetë ofrues i sigurisë dhe faktor stabiliteti në rajon.















Qendra e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve përgatit liderë të FSK-së

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) shumicën e trajnimeve për oficerë dhe nënoficerë i kryejnë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, ku, në kuadër të saj, ka 4 shkolla profesionale. Njëra nga shkollat është edhe Qendra e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve (QZHPU), e cila është njësi vartëse e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) e themeluar në vitin 2009, kur edhe është themelumarra këtu, në njësitet e tyre. Misioni i QZHPU-së është shkollimi dhe stërvitja e pjesëtarëve të FSK-së, për t'i përgatitur sa më mirë (në aspektin teorik dhe atë praktik) në kryerjen e detyrave të tyre, për t'i udhëhequr me efikasitet operacionet ushtarake dhe ato jo ushtarake. Personeli i kësaj shkolle që nga themelimi i saj, është angazhuar në organizimin dhe përpilimin e programeve të kurseve në përputhje me konceptin e trajnimit në FSK dhe konceptin për zhvillimin e personelit të FSK-së, duke u bazuar në misionin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe të FSK-së.

Nënkolonel Haxhosaj, shpjegon se kurset e para që kanë filluar t'i realizojnë në vitin 2009, kanë qenë një fillim i mirë dhe i suksesshëm për QZHPU-në dhe në atë kohë trajnimet e zhvilluara janë monitoruar edhe nga ekipet trajnuese të NATO-s, kurse tani këto trajnime mbahen shumica vetëm nga trajnues të FSK-së, që janë të certifikuar për çdo lëmi. "Në vitin 2009 në QZHPU, kemi mbajtur dy Kurse Bazike për Nënoficerë dhe për Oficerë të rinj, për gjeneratat e para, të cilat janë realizuar nga ekipi trajnues i NATO-s, kurse, pas këtyre gjeneratave, Kurset Bazike për Nënoficerë dhe Oficerë, janë marrë përsipër të realizohen nga QZHPU-ja, respektivisht kurset e avancuara për oficerë dhe nënoficerë.

Në vitin 2010, QZHPU-ja ka filluar realizimin e kurseve bazike për nënoficerë dhe oficerë, me instruktorët e sajë të monitoruar nga ekipet trajnuese të NATO-s. Gjithashtu duke parë nevojën për avancimin dhe ngritjen e njohurive profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, "ne kemi filluar edhe ndryshimin e programeve të kurseve bazike për nënoficer dhe oficer, duke përshtatur me kërkesat, nevojat e përgjithshme dhe misionin e FSK-së. Përveç kësaj, ne kemi vazhduar përpilimin dhe realizimin e programeve për kurset tjera të avancuara që janë në përbërje të QZHPU-së, në bazë të konceptit zhvillimor të FSK-së dhe direktivave të komandantit të KDS-së" - thotë Haxhosaj.

Disa nga trajnimet që mbahen në këtë shkollë janë: kursi i avancuar për oficer dhe nënoficer, kursi për oficer të karrierës, kursi i gjuhëve të huaja, kursi për informatikë (ECDL). Në kuadër të kësaj qendre, realizohen edhe këto kurse: kursi bazik për nënoficer (grada, tetar, rreshter, kapter, rreshter major).Programi i kursit është trashëguar nga ekipi trajnues i NATO-s, por duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e FSK-së, të dalë nga direktivat e trajnimit, ne kemi bërë ndryshime në programin e kursit, me module të reja trajnuese, duke e përshtatur atë me rolin dhe detyrat e nënoficerëve në FSK. Deri më tani janë realizuar 15 gjenerata në kursin bazik për nënoficer me gjithsej 489 pjesëtarë, nga të gjitha njësitë e FSK-së.

Kursi Bazë për Nënoficer (Ushtarë-Tetarë), Programi i Kursit është trashëguar nga KDS të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ne kemi marrë si model këtë program të kursit dhe kemi modifikuar duke e përshtatur me rolin dhe detyrat e nënoficerëve të rangut Tetar, të FSK-së. Deri më tani janë realizuar 3 gjenerata në Kursin Bazë për Nënoficer, me gjithsej 110 ushtarë, nga të gjitha njësitë e FSK-së. Kursi për Nënoficer Udhëheqës-ky kurs është udhëhequr nga Ekipi i instruktorëve amerikan me bazë në Napoli, në kohëzgjatje prej dy javëve. Këtë kurs e kanë kryer dy gjenerata, gjithsej 105 nënoficer të FSK-së. Kursin Kryesor për Lider- e kanë kryer pesë gjenerata me gjithsej 142 nënoficerë. Kursin për Nënoficer të Lartë- (Rreshter major), e kanë kryer dy gjenerata me gjithsej 87 pjesëtarë. Kursin Bazik për Instruktor të Liderëve Luftarak e ka kryer 1 gjeneratë me gjithsej 12 instruktorë të certifikuar. Ky kurs është mbajtur nga instruktorët e Akademisë së Nënoficerëve të Armatës së 7-të të SHBA-së, në vitin 2012. Kursin për Lider Luftarak e kanë kryer pesë gjenerata me gjithsej 127 nënoficerë. Kursin e Lartë për Nënoficerë (grada; rreshter-kapter) e kanë kryer 1 gjeneratë me gjithsej 40 pjesëtarë. Kursin Bazik për Oficer Rezervë e kanë kryer një gjeneratë me 20 oficerë të rangut Toger dhe Kapiten. Kursi i Avancuar për Oficer (Toger për Kapiten) është realizuar nga 1 gjeneratë prej 11 oficerëve.

Kursi Bazik për Nënoficer Rezervë është realizuar nga 1 gjeneratë me 21 nënoficer. Kursi i Reaguesve të Parë (Shpëtimi i jetës në fushëbetejë) është realizuar nga 1 gjeneratë me 12 instruktorë. Ky kurs është realizuar nga stafi i ekspertëve mjekësorë të KFOR-it amerikan të kampit Bondsteel, për trajnimin e instruktorëve të FSK-së, në vitin 2013. Kursi i Avancuar për Lider për Instruktor- është realizuar nga 1 gjeneratë prej 12 instruktorëve. Ky kurs është realizuar nga Ekipi i instruktorëve të KFOR-it amerikan të kampit Bondsteel, në vitin 2013. Kursi i Avancuar për Lider, është realizuar nga 1 gjeneratë me 28 nënoficerë, të gradës Rreshter për Kapter. Kursi për Media, është janë realizuar në 2 grupe, me gjithsejtë 18 pjesëtarë. Kurset e gjuhës angleze, të cilat realizohen në QZHPU, kanë filluar nga viti 2010 e deri më tani. Numri i përgjithshëm i pjesëtarëve që kanë vijuar Kursin e gjuhës angleze në nivele të ndryshme janë 91 pjesëtarë. Kursi i gjuhës turke, realizohet në kuadër të QZHPU-së, nga instruktorët e KFOR-it Turk, ku deri më tani janë realizuar 3 gjenerata, në periudhën 2012-2014. Gjithsejtë kanë vijuar 75 pjesëtarë. Kursi i informatikës-realizohet në kuadër të QZHPU-së, fillimisht është bërë trajnimi dhe licencimi i 2 instruktorëve të FSK-së në vitin 2013, nga kompania ECDL-Kosova në bashkëpunim me MFSK. Pas certifikimit të instruktorëve, është bërë licencimi i Kabinetit të Informatikës në QZHPU, për të mbajtur kursin e informatikës në KDS, përkatësisht në Qendrën e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve. Deri më tani janë realizuar 2 gjenerata me gjithsejtë 29, dhe deri në fund të këtij viti parashihet të mbahen edhe 2 gjenerata të tjera. Në fund, nënkolonel Haxhosaj shpalos edhe programin e trajnimit për vitin e ardhshëm.







FSK-ja ndërtoi rrugën në fshatin Vërbovc të Drenasit

Batalioni i Xhenios i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) realizoi edhe një projekt humanitar me rëndësi të madhe në shërbim të qytetarëve të Kosovës, ndërtoi rrugën, mbi tri kilometra, në fshatin Vërbovc, Komuna e Drenasit.

"FSK-ja në kuadër të misionit të vet që ka, rëndësi të posaçme po u kushton realizimit të projekteve të ndryshme, e që janë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës", tha shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore,(KFT) kolonel Naim Haziri.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Nexhat Demaku, me këtë rast, falënderoi FSK-së, për angazhimin dhe realizimin e këtij projekti me shumë rëndësi për banorët e këtij fshati. "Ky projekt ishte më se i nevojshëm për banorët e fshatit Vërbovc. FSK-ja po dëshmon se është në shërbim të qytetarëve të Kosovës, për çka unë në emër të komunës i falënderoi shumë."



Shefi i Shtabit të Batalionit të Xhenios, major Ilmi Ramusholli i njoftoi të pranishmit për punën e pjesëtarëve të Batalionit të Xhenios, në rregullimin e rrugës së fshatit Vërbovc. "Qëllimi i realizimit të këtij projekti ka qenë lehtësimi dhe qarkullimi i lirë i banorëve të këtij fshati. Rruga është e gjatë mbi 3 km dhe e gjerë 5 metra, është bërë zgjerimi, rrafshimi dhe hapja e kanaleve anësore dhe janë shtruar mbi 4160 metra kub zhavorr. Kjo rrugë ka rëndësi të veçantë sepse jo vetëm që lidh fshatin, por, vazhdon deri te Lapidari i Komandantit të Lavdishëm të UÇK-së, Ilaz Kodra. Në këtë projekt kanë punuar 8 pjesëtarë të Xhenios me 10 automjete të rënda".



Ndërsa, në emër të fshatit ka falënderuar FSK-së, z. Ilmi Zogu në realizimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për banorët e fshatit të tij.

Në ceremoninë e përurimit të rrugës morën pjesë: Komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO), gjeneralbrigade Ilaz Dërguti, shefi i shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri, kryetari i Komunës së Drenasit Nexhat Demaku, përfaqësues të Batalionit të xhenios të FSK-së dhe shumë qytetarë të fshatit. Simbolikisht prerjen e shiritit e bënë: Gjeneral brigade Ilaz Dërguti, kolonel Naim Haziri, kryetari i Drenasit, zotëri Nexhat Demaku dhe përfaqësuesi i fshatit Vërboc.

Në fund, të gjithë pjesëmarrësit e kësaj ceremoni bënë homazhe dhe vendosen lule të freskëta në Lapidarin e Ilaz Kodrës.



FSK çdo herë e gatshme t'u dalë në ndihmë qytetarëve

Një Njësit i Kërkim-Shpëtimit i FSK-së, më 18 gusht 2014, ka intervenuar në lumin "Morava" në Dobërqan të Gjilanit, për ta ndihmuar Hoyredin Zeqirovcin (qytetar i nacionalitetit turk, nga ky fshat) i cili duke kaluar lumin "Morava " me traktor është fundosur në lum. Batalioni i Parë i Reagimit të Shpejt me të marr informatën ka koordinuar punët me Brigadën e Mbështetjes Operacionale të cilët menjëherë kanë angazhuar një ekip të kërkim-shpëtimit. Ekipi i kërkim-shpëtimit në përbërje prej 4 zhytësve, me ndihmën e një ekskavatori privat, pas 40 minutash, ka arrit ta nxjerr traktorin (e fundosur në një thellësi prej 4 metrash). Njësitet e FSK-së, në çdo kohë, janë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Fëmijët nga Organizata Joqeveritare "Duart Plot Mëshirë" vizitojnë Kazermën e FSK-së në Istog

Në kuadër të vizitave në kazermat e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ditë më parë, për një vizitë në kazermën e FSK-së, "Ushtarët e NATO-s" në Istog, qëndruan fëmijët dhe edukatore të Organizatës Jo Qeveritare "Duart Plotë Mëshirë", të cilët u pritën dhe u shoqëruan gjatë tërë kohës, nga pjesëtarët e Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH).

Gjatë vizitës, fëmijët dhe edukatorët drekuan në kuzhinën e Kazermës, së bashku me pjesëtarët e BRSH-së, të cilët u ndanë shumë të kënaqur me pritjen, shoqërimin e tyre nga ana e pjesëtarëve të FSK-së.

Ndërsa, drejtori i kësaj organizate, z. Rudolf Krasniqi, shprehu falënderim për "dhënien e mundësisë për këta fëmijë që të shohin nga afër Forcën tonë, të njihen me të, si dhe të bashkëbisedojnë me pjesëtarët e FSK-së".





Organizata Jo Qeveritare "Duart Plotë Mëshirë" është organizatë me seli në Pejë, e cila ka për mision ofrimin e përkrahjes materiale dhe përkrahjes në forma tjera për fëmijët me ngecje në zhvillim, fëmijë të familjeve me gjendje të rëndë ekonomike, etj.

Gjithashtu, Organizata "Duart Plotë Mëshirë" ka ndihmuar dy pjesëtarë të BRSH-së, për shërim jashtë vendit si dhe ka ndihmuar në sigurimin e terapive të ndryshme për nevojat e familjarëve të pjesëtarëve të FSK-së.

Intervistë me këshilltarin e komandantit të FSK-së, nënkolonelin David Jones, oficer nga Mbretëria e Bashkuar

FSK-ja ka shumë talentë të futbollit



Gazeta "Forca Jonë": *Nënkolonel Jones, Ju e kryeni detyrën e këshilltarit të komandantit të FSK-së, si ju lindi ideja të merreni edhe me klubin e futbollit në kuadër të FSK-së?*

Nënkolonel Jones: E dija se futbolli ishte jashtëzakonisht i popullarizuar në Ballkanin Perëndimor dhe kam dëgjuar se FSK-ja ka pasur një reputacion shumë të mirë duke luajtur futboll të vogël në hapësira të mbyllura, por jo edhe për versionin e futbollit të madh. Ka disa futbollistë shumë të mirë në FSK dhe doja të shikoja lojtarët që luanin në ekipe të vogla, si dhe kuptova se ata do të jenë të mirë në futboll të madh! Unë kam luajtur futboll kur isha i ri dhe jam trajner i kualifikuar me një reputacion të mirë, kështu që mendova se këtë përvojë mund ta sjelli në klubin e futbollit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).



Gazeta "Forca Jonë": *Cilët kanë qenë hapat e parë që i morët për përgatitjen e ekipit të FSK-së, cila ka qenë barriera gjuhësore dhe bashkëpunimi me pjesëtarë-futbollistë të FSK-së?*

Nënkolonel Jones: Gjithmonë do të ketë sfida në sport. Disa kanë marrë ekipe të luajnë kundër nesh, pasi që FSK-ja nuk ka qenë në gjendje të luaj futboll kundër të gjitha ekipeve në Ballkan, si dhe ekipet e tjera nuk janë të organizuara dhe kanë premtuar se do të luajnë, por pastaj kanë ndryshuar mendjen duke thënë se nuk janë në dispozicion! Blerja e fanellave të futbollit nuk ishte përvojë e lehtë për të marrë cilësinë e duhur; lejimi i lojtarëve për trajnim dhe ndeshje nuk ka qenë gjithmonë e lehtë, por deri më tani gjithçka ka shkuar mirë. Gjuha nuk është një pengesë, pasi që unë e kam Arsim Rexhën i cili është dora e djathtë për mua për të thyer pengesat e gjuhës dhe futbolli është një lojë ku gjuha nuk është fjala e folur por veprimet, përvoja dhe ndjenja!

Gazeta "Forca Jonë": *Sa ndeshje keni luajtur dhe komenti juaj për lojën dhe rezultatet e para?*

Nënkolonel Jones: Deri më tani kemi luajtur 5 ndeshje; tri me klube vendore, të cilat luajnë në ligën e Parë dhe të Dytë të Kosovës dhe një ndeshje me KFOR-in dhe një me ekipin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Gazeta "Forca Jonë": *Zyrtarisht keni zhvilluar edhe dy takime futbolli në nivel ndërkombëtar, ndërmjet KFOR-it dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, cilat janë përshtypjet tuaja?*

Nënkolonel Jones: Kam qenë i kënaqur me lojën e mirë të ekipit të FSK-së, në të dyja ndeshjet. KFOR-in e kemi mundur me rezultat 2-0. Ishte ndjenjë e mirë për të mposhtur ekipin e NATO-s pasi që ata janë ekip me lojtarë me të zgjedhur se sa FSK-ja. Ndërsa, ndeshja me ekipin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FASH) ishte një ndeshje e veçantë për ne, me ç'rast organizuam edhe një pritje të veçantë për mysafirët dhe miqtë tanë nga Shqipëria. Ndeshja përfundoi 0-0, por të jemi të sinqertë, kemi pasur mundësi ta fitojmë këtë ndeshje pasi që kemi goditur shtyllën 4 herë. Sidoqoftë, unë mendoj se rezultati ishte i mirë në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Unë me padurim e pres ndeshjen e kthimit që do të mbahet në Tiranë, gjatë këtij viti.



Gazeta "Forca Jonë": *Zoti nënkolonel, Ju lutem a mund të tërhiqni një paralele në mes të futbollin që zhvillohet në ushtrinë e Anglisë dhe atë të FSK-së, dhe cila është e ardhmja e futbollit të FSK-së?*

Nënkolonel Jones: Futbolli që zhvillohet në kuadër të Ushtrisë në Britaninë e Madhe ka një traditë të gjatë, mbi 125 vjet, dhe është i nivelit të lartë profesional. Për shembull, Inxhinierët Mbretëror, trupa të cilës i takojë edhe unë, ka fituar Kupën e Shoqatës së Futbollit (FA Cup) në vitin 1880, të njëjtën Kupë, të cilën e fitoi KF "Arsenali" sezonin e kaluar. Pra, njësitet luajnë gara të brendshme; njësitet luajnë turne në mes të njësive, pastaj organizohet futbolli i përfaqësues të Trupave në nivel përfaqësues. Në vitet e fundit, në kuadër të ushtrisë britanike, ka pasur një rritje e vërtet edhe në futbollin e femrave.

Gazeta "Forca Jonë": *Në muajin shtator ju presin edhe shumë takime, a mund të na thoni më shumë për këtë?*

Nënkolonel Jones: Po, në fillim të shtatorit, kemi një ndeshje në pritje kundër Forcave të Armatosura të Malit të Zi, dhe shpresojmë të zhvillojmë ndeshje të tjera edhe kundër ushtrisë së Maqedonisë, si dhe ndeshjen e kthimit kundër FA të Shqipërisë, plus pa dyshim ndeshje të tjera vendore për t'i mbajtur lojtarët në formë.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është mesazhi juaj për futbollistët e FSK-së ?.*

Nënkolonel Jones: Ka qenë një fillim i mirë në zhvillimin e ekipit të FSK-së dhe ne kemi arrit ta ndërtojmë bazën-themelin për të ardhmen. Për këtë, për mua është një kënaqësi dhe nderë që kam ndihmuar sadopak në profesionalizimin e futbollit të FSK-së. Unë i përgëzoj të gjithë lojtarët e FSK-së dhe besoj se ata do ta përfaqësojnë FSK-në me sukses, edhe në takimet që pritet të mbahen gjatë këtij viti, në Maqedoni, Shqipëri dhe Mal të Zi.

FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 28 • Tetor 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i FSK-së, Agim Çeku priti komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Francesko Paolo Figliuolo



Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, priti sot në ambientet e Ministrisë së FSK-së, komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Francesko Paolo Figliuolo, me ç'rast edhe njëherë i uroi detyrën e re si komandant i KFOR-it.

Kjo është vizita e parë e komandantit të KFOR-it, gjeneralit Francesko Paolo Figliuolo, në Ministrinë e FSK-së, prej se ka marrë detyrën e re të komandantit të KFOR-it.

Ministri Çeku, e njoftoi komandantin e KFOR-it, me të arriturat e përgjithshme dhe perspektivën e FSK-së.

Takimi i sotëm kishte karakter njohës dhe njëherësh rikonfirmoi vazhdimin e bashkëpunimit dhe partneritetit në mes të FSK-së dhe KFOR-it edhe në të ardhmen.

Komandanti i KFOR-it, gjenerali Francesko Paolo Figliuolo, ritheksoi vazhdimin e këtij bashkëpunimi.

Bejtush Gashi priti zëvendëspresidentin e Odës Ekonomike të Çekisë

Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK) z. Bejtush Gashi, më 26 shtator 2014, priti në një takim pune, zëvendëspresidentin e Odës Ekonomike të Çekisë, z. Millan Zavada. Zëvendësministri Gashi dhe zëvendëspresidenti i Odës Ekonomike të Çekisë, z. Zavada biseduan për bashkëpunim dhe përkrahjen e Çekisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.





Gjenerallejtënant Kadri Kastrati mori pjesë në konferencën e 22-të vjetore të ushtrive evropiane, në Wiesbaden të Gjermanisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati i shoqëruar edhe nga kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, morrën pjesë në konferencën e 22-të vjetore të ushtrive evropiane, që u mbajt në Wiesbaden të Gjermanisë (15-17 shtator 2014).

Konferenca u mbajt në organizimin e "US Army Europe" dhe ku marrin pjesë personalitete udhëheqëse të ushtrive të Evropës dhe komandanti i "US Army Europe", gjenerallejtënant Donald M. Campbell.

Punimet e konferencës janë ndarë në pesë sesione me tema të ndryshme.

Sesioni i parë është i fokusuar në përfitimet e ndërveprueshmërisë, dhe se si trajnimet në kohë paqeje në nivel shtabesh ndihmojnë qasjen e integruar të komandës, kontrollit, komunikimit, kompjuterëve, inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit.

Në sesionin e dytë diskutohet zbarkueshmëria dhe kapacitetet e partnerëve individual, ndërsa në sesionin e tretë diskutohet për bashkëpunimin dhe angazhimin ndërmjet partnerëve për të siguruar mbështetje për objektivat e përbashkëta.

Sesioni i katërt fokusohet në përfitimet e konceptit të NATO-s, për bashkimin e iniciativave të forcave partnere në operacionet e ardhshme të Aleancës, ndërsa sesioni i pestë ka në fokus se si ushtritë e ardhshme evropiane e aziatike do të angazhohen bashkërisht ndaj kërcënimeve të përgjithshme. Konferenca e 22 -të vjetore, pritet që më 17 shtator t'i përfundojë punimet.

Në stërvitjen shqiptaro-britanike "Albanian Lion '14" mori pjesë edhe FSK-ja



10 oficerë të rinj të FSK-së, prej tyre 9 oficerë të cilët kanë diplomuar në Akademinë Mbretërore Ushtarake në Sandhurst (RMAS), Mbretërinë e Bashkuar, kanë marrë pjesë në stërvitjen shqiptaro-britanike "Albanian Lion"14" mbajtur në Shqipëri.

Ky ushtrim është mbajtur me rastin e trevjetorit të zbarkimit të përbashkët të grupit të Task Forcës Britanike dhe Forcave të Armatosura Shqiptare, ndërsa, oficerët e rinj të FSK-së, me pjesëmarrjen e tyre në ushtrimin Albanian Dagger 14 (Kama shqiptare 14) kanë bërë histori.

Forcat Britanike, në këtë ushtrim kanë angazhuar 600 marinar mbretëror (RM) dhe 1500 marinar të flotës ushtarake etj., *(vijon në faqen 2)*

Në stërvitjen shqiptaro-britanike "Albanian Lion '14" morën pjesë edhe oficerë të FSK-së

Oficerët e rinj të FSK-së bënë histori

Nënkoloneli
DAVID JONES



10 oficerë të rinj të FSK-së, përfshirë 9 oficerë të cilët kanë diplomuar në Akademinë Mbretërore Ushtarake në Sandhurst (RMAS), kanë bërë histori më pjesëmarrjen e tyre në ushtrimin Albanian Dagger 14 (Kama shqiptare 14).

Ky ushtrim është mbajtur me rastin e trevjetorit të zbarkimit të përbashkët të grupit të Task Forcës Britanike dhe Forcave të Armatosura Shqiptare.

Forcat Britanike kanë angazhuar 600 marinarë mbretërorë (RM) dhe 1500 marinar të flotës ushtarake (RN), 4 RN anije, helikopterë të operatorit HMS Oqean dhe helikopterë të shpejtë.

Faza e parë e ushtrimit ka qenë e fokusuar në lëshimin në tokë dhe në ujë në bazën detare të Kepit të Palit, nga Task Forca Britanike e cila ka përfshirë hedhjen e marinës mbretërorë në det dhe tokë duke ecur këmbë dhe me makina të armatosura Viking.

Oficerët e rinj të FSK-së kanë qenë të përfshirë në mbrojtjen e bazës detare të Kepit të Palit, duke punuar përkrah kolegëve të marinës mbretërore, sipas skenarëve të tyre, duke iu kundërvënë forcave të armikut kundër sulmit pasues britanik. Për dy ditë oficerët e FSK-së kanë përgatitur mbrojtjen dhe kanë luftuar kundër kërcënimit që pritet të vijë nga deti. Oficerët e FSK-së kanë mësuar rreth taktikave të marinës mbretërore në mbrojtje, kanë rishikuar 7 pyetjet (çështjet) të vlerësuara në nivel batalioni dhe mësuan si të jetojnë në fushë (terren). Ka qenë një periudhë e vështirë për pjesëtarët e FSK-së, por që do t'u mbetet në kujtesën e tyre gjatë gjithë karrierës ushtarake.

Brigadieri Charlie Stickland, komandant i Brigadës 3 Commando tha: "Ka qenë e mrekullueshme t`i kemi oficerët e FSK-së në ushtrim, ku kanë vepruar në një mjedis kompleks dhe kërkues. Ata kanë treguar performancë shumë të mirë përkrah marinarëve të mi dhe i falënderoi për profesionalizmin, shkathtësitë dhe entuziazmin e tyre".

Në stërvitjen e përbashkët shqiptaro - britanike "Albanian Lion '14", nga forcat pjesëmarrëse u realizuan një varg demonstrimesh ushtarake, sulme amfibe nga deti, simulim i luftimeve në zona urbane, etj. Kjo stërvitje u zhvillua në disa rajone të Shqipërisë, si në Bizë, në Zall-Herr, në Kepin e Palit, në Kuçovë, në Pashaliman dhe në Porto Palermo dhe u mbështetën nga deti me katër anije ushtarake. Gjatë stërvitjes, baza detare e Kepit të Palit u shfrytëzua si bazë për furnizime logjistike dhe si bazë për largimin e trupave dhe automjeteve pjesëmarrëse në "Albanian Lion 2014".



Komandanti i KFT-së, gjeneral Rrahman Rama vizitoi Brigadën për Reagim të Shpejtë në Istog

Komandanti i Forcave Tokësore (KFT) dhe zëvendëskomandant i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, me bashkëpunëtorë (nënkolonel David Jones, këshilltar i komandantit të FSK-së dhe majori Melitton, nga Ambasada Amerikane) dje qëndroi për një vizitë pune, në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagimit të Shpejtë (BRSH) në Istog.

Qëllimi i vizitës së gjeneral Rrahman Ramës, ishte përcjellja nga afër e ushtrimeve parapërgatitore të njësiteve të Brigadës për Reagim të Shpejtë, të cilët janë duke realizuar "Ushtrimin në Vendkomandë" (UVK).

Komandantin e KF'T-së, e priti komandanti i BRSH-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, i cili e njoftoi për realizimin e ushtrimeve dhe trajnimeve të njësiteve të BRSH-së.

Batalioni i Parë i BRSH-së, që nga 15 shtatori 2014, ka filluar realizimin e Ushtrimit në Vendkomandë (UVK), njëkohësisht edhe Kompania 2A e Batalionit të Dytë është duke realizuar ushtrimin fushor "Taktikat për Njësi të Vogla", gjenerata 3/2014.

Një ekip i oficerëve të Ushtrisë Amerikane dhe Gardës Kombëtare të IOWA-s, po asistojnë gjatë mbajtjes së ushtrimit.

Me këtë rast, gjeneralmajor Rrahman Rama përgëzoi oficerët dhe ushtarët e BRSH-së, për angazhimin e tyre në realizimin e këtij ushtrimi, si dhe falënderoi ekipet e Ushtrisë Amerikane dhe të Gardës Kombëtare, që po kontribuojnë në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së.

Komandanti i KF'T-së, gjeneral Rama, gjithashtu, vizitoi pjesëmarrësit në seminarin "Legal Aspects of Developing a Professional Military" (Aspektet Juridike të Zhvillimit Profesional Ushtarak) e organizuar nga Zyra për Bashkëpunim e Mbrojtjes të Ambasadës Amerikane në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Në këtë seminar po marrin pjesë 30 pjesëtarë të FSK-së.

Gjeneralbrigade Peter Braunstein vizitoi Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi, priti sot, në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të FSK-së, në Ferizaj, shefin e Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës të NATO-s (NLAT), gjeneralbrigade Peter Braunstein, në një vizitë njohëse. Kjo ishte vizita e parë e gjeneralit Peter Braunstein, që i bëri Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Me këtë rast, komandanti i KDS, gjeneral Cikaqi e njoftoi shefin e NLAT, gjeneralin Braunstein me të arriturat e përgjithshme të KDS-së, me trajnimet, shkollimet etj.



Ata së bashku vizituan shkollat e KDS-së dhe përcollën nga afër disa nga trajnimet të cilat janë duke u realizuar në këto shkolla.

Shefi i Ekipit Këshillues i NATO-s, (NLAT), gjenerali Braunstein, gjatë trajnimeve bashkëbisedoi me pjesëtarë të FSK-së.

Gjenerali Braunstein, me këtë rast, tha: "Kudo që i kam vizituar njësitet e FSK-së, kam vërejtur një entuziazëm të lartë për t'u përgatitur sa më mirë, si dhe vullnetin e pjesëtarëve për ta avancuar FSK-në, në nivel më të lartë profesional. Mirëpo, ajo që pash sot, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, këtu në Ferizaj, është se ju po realizoni një numër të madh të trajnimeve me sukses, nga vetë instruktorë e KDS-së, kjo është gjë shumë e mirë". Në fund, gjenerali Peter Braunstein premtoi bashkëpunimin edhe në të ardhmen dhe mbështetjen e FSK-në, në ato pjesë ku kanë më shumë nevojë pjesëtarët e FSK-së, e sidomos në trajnime, ku kapacitetet e FSK-së, janë më të vogla, dhe bashkërisht do t'i avancojmë.

Komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi, falënderoi gjeneralin Braunstein për vizitën dhe ndihmën e vazhdueshme të ekipit të NLAT-it, që po i japin Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Intervistë me Sefer Isufin, nënkolonel i FSK-së

Nënkoloneli Isufi diplomoi me sukses në Kolegjin e Luftës të Forcave të Armatosura të Turqisë

Forcat e Armatosura të Turqisë si anëtare të NATO-s, përmes ekipeve në kuadër të KFOR-it, por edhe në kuadër të strukturës së saj autonome po kontribuojnë vazhdimisht në forcimin e kapaciteteve të përgjithshme të Forcës së Sigurisë të Kosovës drejt realizimit të objektivave të saj.
Marrëveshja për Bashkëpunim në mes të Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë, në dhjetor të vitit 2009, përveç tjerash, parasheh edhe shkollimin dhe arsimimin e personelit ushtarak.
Në periudhën trevjeçare akademike 2011/2014, në Kolegjin e Luftës së Forcave të Armatosura të Turqisë, për herë të parë nga Kosova i kreu studimet nënkolonel Sefer Isufi, dhe fitoi titullin; Oficer i Lartë Karriere i Shtabit të Përgjithshëm dhe njëkohësisht ka përfunduar studimet në shkallën Master, me notë të lartë, në profilin: Arti i Menaxhimit dhe Lidershipit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare, me temën: "Studimi i ndikimit të anëtarësimit të Kosovës në NATO, në paqen, stabilitetin dhe sigurinë e Ballkanit". Nënkolonel Sefer Isufi në këtë Kolegj studioi krahas studentëve nga: SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Kina, Koreja Jugore, Pakistani, Ukraina, Egjipti, Algjeria, etj. Për të kuptuar më shumë, rreth studimeve në kolegjin e Luftës në Turqi, biseduam me nënkolonel Isufin për lexuesit e gazetës: "Forca Jonë"

Gazeta "Forca Jonë": *Zoti nënkolonel a mund të na ofroni informacione lidhur me Kolegjin e Luftës së Forcave të Armatosura të Turqisë dhe misionin e saj?*
Nënkolonel Sefer Isufi: Kolegji i Luftës është themeluar në vitin 1848. Ky Kolegj ka ruajtur vazhdimësinë deri më sot, me zgjerim gradual të niveleve, fushave e profileve akademike krahas nevojave për kuadro profesionale dhe të specializuara vetjake dhe konkurruese me kolegjet më prestigjioze në Botë. Komanda e Kolegjit të Luftës së Forcave të Armatosura të Turqisë është institucioni më i lartë arsimor ushtarak në Turqi dhe përbëhet nga: Kolegjet e Luftërave Tokësore, Ajrore dhe Detare, Kursin për Menaxhimin dhe Administrimin e Lartë të Forcave të Armatosura, Institutin për Hulumtime Strategjike dhe Kursin për Oficer Komandues dhe Shtabor. Në të gjitha këto institucione Forcat e Armatosura të Turqisë përgatisin kuadrot e veta profesionale të oficerëve në të gjitha profilet dhe nivelet udhëheqëse, komanduese dhe planifikuese të formacioneve të saj. Ndërsa, nga viti 1935, në këtë Kolegj kanë filluar studimet edhe oficerë të vendeve mike dhe aleate të Turqisë, dhe deri më tani, kolegjin e kanë kryer mbi 1000 oficerë, nga 50 shtete të huaja. Kisha nderin dhe privilegjin e madh që për herë të parë në këtë ?nstitucion prestigjioz ushtarak të shpalos flamurin e shtetit të Kosovës krahas flamujve të 50 shteteve anekënd Botës, në mesin e tyre edhe shumë superfuqive ushtarake si: SHBA-ve, Anglisë, Gjermanisë, Kinës, Kores Jugore, Pakistanit, etj.

Gazeta "Forca Jonë": *Si e pritët përzgjedhjen tuaj, si oficer i parë i FSK-së, për të studiuar në këtë kolegj të mirënjohur ushtarak?*
Nënkolonel Sefer Isufi: Me marrjen e njoftimit nga Ministria e FSK-së, përkatësisht nga Komandanti i FSK-së për përzgjedhjen time për të ndjekur këtë kolegj, për periudhën trevjeçare, isha shumë i vetëdijshëm për përgjegjësinë e lartë që kisha mbi vete për disa arsye: e para, përfaqësoja popullin, e dyta shtetin dhe e treta ushtrinë tonë dhe këtë duhet ta beja para oficerëve nga të gjitha anët e Botës, në mesin e tyre një pjesë e madhe e shteteve që ende nuk e kishin njohur shtetin tonë. Prandaj sfida ishte shumëdimensionale, të përfaqësoja imazhin e vërtetë se jemi komb i qytetëruar, më histori dhe kulturë të lashtë dhe se Kosova është shtet i ri me perspektivë të qartë dhe se Forca e Sigurisë së saj, përkundër që është forcë e re, ka kapacitete kuadrosh profesionale të përgatitura sipas standardeve më të avancuara të ushtrive bashkëkohore, konkretisht të NATO-s.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili ishte programi akademik që ndoqët gjatë kësaj periudhe të studimeve?*
Nënkolonel Sefer Isufi: Sipas praktikës akademike të sistemit arsimor ushtarak të Forcave turke dhe Komandës së Kolegjit të Luftës, vitin e parë të studimeve e kam ndjekur, në Qendrën Ushtarake të Gjuhëve të Forcave Tokësore, dy nivele të kursit të gjuhës turke, në paralelet e stafit ushtarak ndërkombëtar si dhe njohuri të përgjithshme lidhur me strukturën organizative dhe terminologjinë ushtarake turke. Vitin e dytë dhe të tretë kam pasur një program shumë të ngjeshur dhe voluminoz, studimet në Kolegjin e Luftës (Profili Tokësor) të ndara në 6 semestra me programin në fushën e zhvillimit individual dhe kulturës së përgjithshme të oficerit të karrierës, me qëllimin kryesor për aftësimin e oficerit për planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve tokësore, operacioneve të përbashkëta dhe operacioneve të kombinuara me fokus nga departamentet e inteligjencës dhe operacioneve në nivelin taktik, operacional dhe strategjik në të gjitha nivelet e organizimit strukturor ushtarak prej batalionit, brigadës, divizionit, korpusit e deri në forcë në fushëveprim sulmi, mbrojtje dhe kundërsulmi.



Gazeta "Forca Jonë": *Ju keni kryer edhe programin e masterit me notë të lartë?*
Nënkolonel Sefer Isufi: Po krahas programit akademik, me fokus të ngushtë, në fushën e planifikimit dhe ekzekutimit të operacioneve tokësore, të përbashkëta dhe atyre të kombinuara të realizuara në formë teorike, simulative dhe praktike, kemi ndjekur edhe programin e shkalles Master, me fokus të Shkencave të Menaxhimit dhe Lidershipit, Historisë së Luftërave, Marrëveshjeve dhe të Drejtës Ndërkombëtare, Marrëdhënieve Ndërkombëtare si dhe Strategjisë së Sigurisë.
Meqë ishte edhe objektivi yni parësor anëtarësimi i Kosovës në NATO, duke njohur pozicionin e Turqisë, në këtë organizatë dhe oficerëve të shteteve tjera të NATO-s, pjesëmarrëse në Kolegj, i vura vetes detyrën dhe përgjegjësinë e lartë, që me qasje studimore të shqyrtoj këtë temë: "Studimi i ndikimit të anëtarësimit të Kosovës në NATO, në paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Ballkan". Ky studim i përmbledhur në rreth 70 faqe, është vlerësuar lart, nga niveli i stafit komandues dhe mësimor të Kolegjit dhe është certifikuar në kartotekën zyrtare të Bibliotekës së Kolegjit për shërbim si referencë shkencore për të interesuarit.
Fokusi im ishte që për studiuesit e fushave të ndryshme dhe të interesuarit tjerë të sjell me argumente shkencore realitetin historik, politik, gjeostrategjik, raportet dhe rrethanat tejet komplekse rajonale sidomos me zhvillimet e fundshekullit të kaluar, si dhe ndikimin e pashmangshëm dhe vendimtar të Kosovës në konstelacionin rajonal dhe më gjerë. Me këtë realizim edhe kam mbrojtur shkallen Master, në profilin: Arti i Menaxhimit dhe Lidershipit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare.

Gazeta "Forca Jonë": *Kolegji i Luftës i Ushtrisë Turke ka një traditë të gjatë të punës shkencore, ku kanë studiuar edhe ushtarakë dhe politikanë të shteteve të ndryshme?*
Nënkolonel Sefer Isufi: Kolegj i Luftës ka traditë 166 vjeçare, si institucioni më i lartë, nga i cili kanë dalë kuadro shumë të shquara ushtarake të cilët kanë bartur edhe përgjegjësi të burrështetasve, përgjegjësi të larta institucionale, diplomatike dhe politike të shteteve përkatëse. Ne këtë Kolegj, ka studiuar edhe vet themeluesi i Republikës së Turqisë Mustafa, Kemal Ataturku, kurse nga Shqipëria, ministri i Parë i Mbrojtjes së Shqipërisë në Qeverinë e ?smail Qemalit, gjeneral Mehmet Deralla dhe shefi i Parë i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare gjeneral Ali Shefqet Shkupi.

Gazeta "Forca Jonë": Njohuritë e fituara në Kolegjin e Luftës si do t'i praktikoni në Forcat e Armatosura të Kosovës?
Nënkolonel Sefer Isufi: Duke mos u shmangur nga thelbi i pyetjes suaj, është një fakt që më ka bërë nder të madh në ceremoninë e diplomimit, kur prezantoheshim para të pranishmeve nga udhëheqja më e lartë e shtetit turk, e deri te përfaqësuesit e rreth 30 vendeve të ndryshme të Botës. Shefi i Stafit Akademik të Kolegjit më prezantoi si oficer të Forcave të Armatosura të Kosovës. Meqë edhe Turqia si vend shumë i besueshëm i NATO-s, në kuadër të programit akademik ka në përdorim standardet më të avancuara të shteteve kryesore të NATO-s, kjo lehtëson shumë mundësinë që përvojën dhe njohuritë e mia të fituara të mund t'i zbatoj me lehtësi në aspekte të ndryshme të detyrave dhe përgjegjësive shtabore e komanduese, kuptohet duke iu përshtatur specifikave të strukturës sonë organizative, misionit dhe objektivave tona operacionale dhe strategjike.

Gazeta "Forca Jonë": *Stambolli dhe Turqia në përgjithësi pashmangshëm interferojnë në realitetin tonë historik dhe të sotëm. Cila është përvoja juaj gjatë kohës së qëndrimit në Stamboll?*
Nënkolonel Isufi: Kam qenë i interesuar për të njohur sa më shumë historinë e Turqisë, në të cilën kanë jetuar dhe jetojnë mijëra bashkëkombës tanë, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmueshëm për Perandorinë dhe Republikën e Turqisë. Emrat e shumë shqiptarëve të rënë në beteja të ndryshme i kam hasur në pjesën më të madhe të memorialëve përkujtimore të dëshmorëve në regjione të ndryshme të Turqisë prej Qanakalasë e deri në Sarikamish, në kufi me Armeninë. Edhe në kuadër të personelit ushtarak të Akademisë dhe atyre që studionin kam takuar shumë oficerë të rangjeve të ndryshme me prejardhje shqiptare. Kurse gjatë paraqitjeve të mija akademike kam prezantuar, temat: Kosova në aspektin historik, demografik, etnografik, kulturor, Rezistenca Paqësore dhe e Armatosur (1989-1999), Lufta e UÇK-së dhe Ndërhyrja e NATO-s, Planifikimi dhe Ekzekutimi i Operacionit Shigjeta dhe Beteja e Koshares. Pastaj kumtesat: Konferenca e Rambujesë, Problemi i Mitrovicës së Veriut, Problemi i Luginës së Preshevës etj.

Gazeta "Forca Jonë": *Gjatë qëndrimit tuaj në Stamboll keni qenë aktiv edhe në aktivitetet tuaja jashtë mësimore, cilat janë ato aktivitete?*
Nënkolonel Sefer Isufi: Po, në Stamboll pata fatin që gjatë periudhës sa isha në studime të bashkëpunoja ngushtë me Qendrën Kulturore të Kosovës, institucion nën patronazhin e Ministrisë së Diasporës dhe me Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës dhe të Shqipërisë, në Stamboll, si dhe me Shoqatat Shqiptare nga viset tona, me të cilat kemi qenë së bashku në evenimente të ndryshme kombëtare dhe shtetërore. Një prezantim e kam pasur në Qendrën Kulturore të Kosovës, me rastin e përvjetorit të Epopesë së UÇK-së, dhe pjesëmarrjen në manifestimin "Dita e Miqësisë" që organizohet tradicionalisht në Akademi, ku kemi prezantuar me kostumet tona kombëtare dhe sofrën tonë tradicionale e që janë mirëpritur jashtëzakonisht nga të pranishmit.

Gazeta "Forca Jonë": *Në fund, cili është mesazhi i juaj për pjesëtarët e FSK-së që studiojnë jashtë Kosovës?*
Nënkolonel Sefer Isufi: Të gjithë kolegëve të mi që janë në studime dhe atyre që do të fillojnë të studiojnë u sugjeroj të pasqyrojnë imazhin më të mirë të oficerit profesionist bashkëkohor dhe të qasen me seriozitetin më të madh të mundshëm për nxënien e mësimeve të ofruara. Dhe krejt në fund, assesi të ndihen inferior para të tjerëve, sepse kështu do të krijojnë respektin e nevojshëm nga të tjerët, kuptohet krahas angazhimit e përkushtimit të lartë në studime.

Betohen kadetët e rinj të FSK-së

Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), në Prishtinë, më 11 shtator 2014, u zhvillu ceremonia e dhënies së betimit dhe fillimi i vitit të ri akademik 2014-2015, i kadetëve





të Qendrës për Studime Universitare (QSU) të FSK-së, gjenerata 2018.

Në ceremoninë e betimit morën pjesë; ministri i MFSK-së, Agim Çeku, zëvendësministri Bejtush Gashi, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjeneral brigade Nazmi Ibrahimaj, komandant i BRSH-së, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, komandant i KDS-së, përfaqësues të KFOR-it, të NLAT-it, përfaqësues të ambasadës amerikane në Prishtinë, oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it, si dhe familjarë të kadetëve dhe të ftuar të tjerë.

Qendra për Studime Universitare e FSK-së, është themeluar në vitin 2005, si institucion edukativo-arsimor. Në këtë qendër deri më tani kanë kaluar dhjetë gjenerata, prej të cilave, gjashtë gjenerata kanë diplomuar dhe po shërbejnë si oficerë në FSK, ndërsa katër gjenerata po vazhdojnë shkollimin.

Ceremonia e sotme filloi me parakalimin e kadetëve të QSU-së, dhe intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pasi përshëndeti të pranishmit, tha: "Dita e sotme është e një rëndësie të veçantë për Qendrën për Studime Universitare dhe për Forcën e Sigurisë të Kosovës, por dhe për mua personalisht si komandant i FSK-së. Ne jemi të përkushtuar që ta ndërtojmë një forcë moderne e profesionale të sigurisë, të trajnuar mirë dhe të pajisur me infrastrukturë sipas standardeve të Aleancës Veri-Atlantike. Për arritjen e këtij standardi nuk mjafton vetëm dëshira dhe përkushtimi i pjesëtarëve, por duhet edhe ngritja profesionale dhe kjo arrihet vetëm përmes shkollimit dhe trajnimit të kuadrove të reja. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës këtë objektiv e arrin përmes Qendrës për Studime Universitare dhe në bashkëpunim edhe me Universitetin Amerikan në Kosovë dhe universitet tjera të Kosovës dhe jashtë saj".

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati theksoi se edhe këtë vit interesimi i të rinjve, për ta veshë uniformën e kadetit të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, ka qenë shumë i madh, për të shtuar: "Para jush, sot, janë rreshtuar kadetët më të mirë, që me sukses i kanë kaluar të gjitha testimet, si dhe kanë përballuar me sukses javën e fundit, të ashtuquajtur 'java e ferrit'. Për këtë sukses, ju përshëndes dhe përgëzoj".



Gjeneral Kastrati më pas ju drejtua kadetëve të rinj: "Nga sot, ju nuk jeni duke u shkolluar si moshatarët e juaj, për të qenë të vlefshëm vetëm për vete dhe për familjen. Ju sot po e filloni shkollimin tuaj për të qenë të vlefshëm, për vendin, qytetarët e vendit tonë dhe për vetën tuaj. Ju sot, po merrni përgjegjësi të reja, po betoheni para flamurit, para prindërve, para komandantëve tuaj, që do të jeni të përkushtuar ndaj vendit, ndaj atdheut, duke pasur gjithmonë parasysh moton e ushtarakut: nderi, detyra dhe atdheu". Ai shtoi: "Bazuar në gatishmërinë tuaj, përkushtimin dhe profesionalizmin e stafit të QSU-së, shpreh bindjen se detyrat dhe sfidat që na presin, do arrijmë t'i realizojmë qind për qind me realizimin e programeve të shkollimit universitar të QSU-së, të bazuar në dinamikën e planit të përcaktuar nga QSU-ja".

Komandanti i FSK-së, në fund, falënderoi prindërit dhe familjarët e kadetëve për mbështetjen e fëmijëve në realizimin e synimeve dhe dëshirave të tyre, për t'u bërë ushtarë të vendit.

Ndërsa, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku, gjatë fjalës përshëndetëse tha: "Vërtetë, sot, është një ditë shumë e rëndësishme për Forcën e Sigurisë së Kosovës. FSK-ja ka arritje të shumta që neve na bënë të mburremi. Akademia Ushtarake e FSK-së, ka nxjerrë oficerë shumë cilësorë me të cilët ne krenohemi, oficerë konkurrues me ushtritë ma moderne dhe ma të avancuara në Botë. FSK-ja është duke u përgatitur që të marrë mbi vete detyrat ma komplekse, ma serioze, ma sfiduese, detyrat për të cilat ka nevojë ky vend dhe ky popull, për ta mbrojtur sovranitetin, integritetin territorial, jetën dhe pasurinë e qytetarëve të Kosovës, por edhe për të kontribuar në ndërtimin e paqes dhe sigurisë kudo në Botë. Ky fakt dëshmon se ne jemi duke u përgatitur për detyra të reja, duke shkolluar oficerë që mbi vete do t'i bartin këto detyra dhe këto sfida të reja, por mbi të gjitha kjo është një ditë e veçantë për kadetë, me çka dua t'ju përgëzoj se në mesin e 400 kandidatëve që kanë aplikuar për të qenë në këtë rresht, ju jeni përzgjedhur më të mirët, dhe ishit më të mirët në mesin e tyre".

Në fund, ministri Agim Çeku, kërkoi nga kadetët e rinj: "Kërkoj nga ju, që mos të na zhgënjeni as neve, as komandantët tuaj, as familjet tuaja, dhe, ne jemi të bindur se i kemi zgjedhur më të mirët, sepse më të mirët mundën me qenë këtu dhe veç më të mirët mundën me qenë oficerë të FSK-së. Ju po shkolloheni për të qenë të vlefshëm edhe për veten dhe familjen tuaj, por mbi të gjitha për të qenë të vlefshëm për vendin tonë. Ju po merrni përgjegjësi të reja, po betoheni para ministrit, para prindërve, para komandantëve tuaj, që do të jeni të përkushtuar ndaj vendit."

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, ua ka rikujtuar kadetëve të rinj detyrat që duhet t'i kryejnë në të ardhme. "Që nga sot, ju përveç se jeni qytetarë, jeni në radhë të parë ushtarë dhe në çdo situatë, në çdo rrethanë duhet ta dini se kush jeni dhe si duhet të veproni. Ju keni përzgjedhë një profesion të vështirë i cili kërkon vetëmohim, përkushtim dhe guxim, por mbi të gjitha është një profesion shumë fisnik, ku nuk ka gjë më të mirë, se sa shërbimi për vendin dhe popullin tënd. Ju e kishit këtë fat, andaj mos harroni se në asnjë moment nuk duhet të dështoni, përkundrazi duhet të jeni shembull çdo kund; në kazermë, në universitet, në rrugë etj".

Në fund, kadetët e rinj të FSK-së, solemnisht dhanë betimin para komandantit të Qendrës së Studimeve Universitare kapiten Avni Kiçina.

Pas përfundimit të ceremonisë, familjarët së bashku me kadetët, vizituan ambientet e QSU-së, ku u njoftuan me kushtet e kësaj qendre, në të cilën kadetët do të mësojnë dhe qëndrojnë për katër vjet gjatë studimeve.





Intervistë me kadetët e rinj të FSK-së, gjenerata 2018



Saranda Zekolli - Vushtrri

"Forca Jonë": *Si ju lindi dëshira për t'u bërë kadet i FSK-së?*

Kadet Zekolli: Ishte një ndjenjë e veçantë kur i pashë për herë të parë kadetët e FSK-së në televizion. Aty për aty, më lindi dëshira që të bëhem edhe unë kadet i FSK-së. Vitin e kaluar, më kaloi afati i konkurrimit, nuk arrita të konkurroj dhe, pastaj, u regjistruar në Fakultetin Juridik, por mendjen e kisha te FSK-ja. Këtë vit aplikova me kohë dhe tani jam kadet i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së.

"Forca Jonë": *Keni kaluar në shumë procedura testimi !?*


Kadet Zekolli: Ka qenë një procedurë mjaft e gjatë dhe shumë e vështirë. Kemi pasur shumë teste të njëpasnjëshme, të cilat gjatë tërë kohës na kanë mbajtur të stresuar. Unë i kam kaluar me sukses te gjitha testet, dhe pas pranimit vështirësitë harrohen.

"Forca Jonë": *Si ndihesh tani, pas përballimit me sukses të "Javës së Ferrit" ?*

Kadet Zekolli: Kuptohet, tani ndjehem më mirë, sepse kjo ishte një sfidë për mua dhe kadetët tjerë, dhe mua më pëlqen të sprovohem, në kushte dhe rrethana të cilat kërkohen për një kadet të QSU-së. Edhe pse "Java e Ferrit" ka qenë shumë më e vështirë se sa që e kam paramenduar, më në fund jam e gëzuar se arrita t'i përballoj të gjitha.

"Forca Jonë": *Tani është fillimi i studimeve, por, a mund ta mendoni vetën pas katër vitesh studimi në Akademi?*

Kadet Zekolli: Jo, në Akademi duhet punë dhe angazhim maksimal, këtë e kam ma primare, dhe në përgjithësi unë i kam vënë vetës detyrë që të behëm një pjesëtare e denjë e FSK-së, dhe me punën time profesionale së bashku edhe me kadetët tjerë, të jemi imazhi më i mirë i FSK-së.



Shkëlqim Raci - Siqevë, Klinë

"Forca Jonë": *Prej nga dëshira për t'u bërë kadet i FSK-së?*

Kadet Raci: Është një profesion sfidues dhe dëshira ime është të përballem me sfida.

"Forca Jonë": *Po procedurat e testimit sa ishin sfiduese për ju?*

Kadet Raci: Po, të gjitha testet kanë qenë mjaft sfiduese, duke filluar nga teksti fizik, inteligjencës, testi i gjuhës angleze etj. Unë, ka një vit e më shumë që jam përgatitur me ushtrime fizike dhe të tjera, me qëllim të përballimit më të lehtë, dhe këtë e kam arrit.

"Forca Jonë": *Si ndihesh tani, pas pranimit në studime në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së?*

Kadet Raci: Ndjehem i lumtur, sa asnjëherë nuk jam ndier më i lumtur deri më tani, dhe shpresoj që më këtë ritëm të vazhdoj studimet deri në përfundim të Akademisë së FSK-së.

"Forca Jonë": *Si e sheh veten pas 4 viteve?*

Kadet Raci: Unë jam plotësisht i vetëdijshëm, si unë, ashtu edhe kolegët e mi, se kemi zgjedhur një rrugë plot sfida dhe të gjatë. Shpresoj dhe besoj ta kryej me sukses Akademinë dhe ti shërbej vendit tim me nder.



Arelena Shala - Prizren

"Forca Jonë": *Arelena, kush ishin shtytësit tuaj për t'u bërë kadet i FSK-së?*

Kadet Shala: Që të jem e sinqertë, ka qenë një ëndërr e imja e mëhershme që ta veshi uniformën e kadetit të FSK-së, por në këtë drejtim më ka shtyrë edhe familja ime. Ka një vit që jam marrë me përgatitjet për testime. Tani e ndiejë vetën të lumtur që m'u plotësua ëndrra për t'u bërë pjesëtare e Akademisë së FSK-së.

"Forca Jonë": *Sa ishin të vështira procedurat e pranimit në Qendrën e Studimit Universitar të FSK-së?*

Kadet Shala: Nuk kam pas shumë vështirësi gjatë periudhës së testimeve. Pak më i rëndë për mua ka qenë testi fizik, mirëpo me punë të përkushtuar dhe me ushtrime të rregullta kam arrit që ta tejkaloj këtë sfidë.

"Forca Jonë": *Si ndihesh tani si pjesëtare e QSU-së, dhe a ishte sfiduese java e parë e ashtuquajtur "Java e Ferrit"?*

Kadet Shala: Është nder për mua të jem pjesë e QSU-së dhe e FSK-së, dhe ndjehem mjaft mirë që jam pjesë e saj, ndërsa "Java e Ferrit" thënë të drejtën, ka qenë më e vështirë se sa e kam paramendua, mirëpo kam dhënë maksimumin për ta përballuar edhe këtë sfidë.

"Forca Jonë": *Si e sheh veten pas 4 viteve?*

Kadet Shala: Jam shumë e lumtur që u pranova në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së. Për mua primare është puna dhe angazhimi maksimal, t'i kryej studimet me rregull, dhe mos t'i zhgënjej familjarët dhe eprorët e mi, dhe ta kryejë me sukses Akademinë e FSK-së. Pas katër vitesh e shoh veten si një oficere që i zbaton njohuritë e fituara në shërbim të Atdheut .

U certifikuan instruktorët për paramedikë-infermierë ushtarakë



Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, pas përfundimit të kurseve: Reaguesit e Parë në Fushëbetejë dhe Kursi për Lidership Reagues në Fushëbetejë (Infermierë ushtarakë të vijës së parë) realizuar nga instruktorë amerikanë të Kampit Bondstell.

Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KDS gjeneral brigade Enver Cikaqi, shefi i Shtabit të Bondstill nënkolonel Chadwick Shields, shefi i Shtabit të NLAT-it, kolonel Michele Biasiutti, koloneli Chad Butts, atashe ushtarak në Ambasadën e Amerikës, në Prishtinë, si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, falënderoi instruktorët amerikanë për ndihmën e vazhdueshme që po japin në trajnimin dhe profesionalizimin e pjesëtarëve të FSK-së, për të shtuar, se: " Edhe kjo ceremoni e sotme është dëshmi për bashkëpunimin e mirë në mes FSK-së dhe ushtrisë amerikane, këto janë rezultatet të cilat po i shohim edhe ne këtu. Ushtria amerikane po e mbështetë FSK-në, në të gjitha aspektet, për çka ne u jemi mirënjohës dhe falënderues. Pa dyshim që kontributi i instruktorëve amerikanë ka qenë jashtëzakonisht i lartë". Në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, kërkoi nga pjesëtarët e certifikuar të FSK-së, që trajnimet e tilla të avancohen më tej, si dhe dituritë e marra këtu, t'i shpërndajnë në njësitet e tjera të FSK-së, në të kundërtën, nuk do ta kenë vlerën e tyre, theksoi gjeneral Kastrati.

Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, në fjalën e tij tematike, tha: "Partneriteti strategjik me ushtrinë amerikane dhe qasja e FSK-së, në përgjithësi dhe e KDS-së, në veçanti për të sjellë profesionalizmin dhe standardet e ushtrisë amerikane tek personeli ushtarak në FSK, çdo ditë po tregon rezultate të kapshme. Për pesë vite e gjysmë kemi realizuar trajnime të përbashkëta me ushtrinë amerikane, dhe sot, rezultatet e këtyre trajnimeve i shohim kudo nëpër njësitë e FSK-së dhe jo vetëm në KDS, për çka ndihemi mirë, se kemi arrit t'i adaptojmë këto kurse brenda programit tonë trajnues, njëherësh shprehu falënderimin për ushtrinë amerikane, që në çdo kohë, na kanë mbështetur me instruktorë, ashtu edhe me programe trajnuese". Enver Cikaqi, në fjalën tematike, tha: "Partneriteti strategjik me ushtrinë amerikane dhe qasja e FSK-së në përgjithësi dhe KDS-së në veçanti për të sjellë profesionalizmin dhe standardet e ushtrisë amerikane tek personeli jonë ushtarak në FSK, çdo ditë po tregon rezultate të kapshme. Gjatë 5 viteve e gjysmë të punës së FSK-së ne kemi realizuar një varg aktivitetesh stërvitore të përbashkëta me ekipe të shumta të ushtrisë amerikane të cilat kanë mundësuar që profesionalizmi individual i njësive dhe FSK-së në përgjithësi të orientohet drejt standardeve të larta . Gjatë bashkëpunimit me KFOR-in amerikan të Kampit Bondsteel, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes ka vlerësuar, që një fokus të veçantë, t'i kushtohet përgatitjes së instruktorëve të FSK-së, për të qenë në gjendje që të forcojnë njohuritë profesionale sipas standardeve, si dhe bartjen e programeve dhe kurseve nga doktrina e ushtrisë amerikane dhe përshtatjen e tyre për FSK-në. Ushtarakët tanë të niveleve të ndryshme, që kanë marrë pjesë në këto dy kurse, si trajnerë të trajnuar në Kursin për Reagues të Parë dhe Kursin për Lidership Reagues, të cilët kanë përfunduar me sukses këto kurse, do të shfrytëzohen në të ardhmen për stërvitjen e nënoficerëve dhe oficerëve në të gjitha njësitë e FSK-së.

Kursi i Reaguesve të Parë, ndryshe quhet edhe Kursi i Mbijetesës në Fushëbetejë (shpëtimi i jetës së luftëtarit në fushëbetejë), është një kurs që ka përfshirë pjesën teorike dhe praktike për fazat e ndryshme të kujdesit për të plagosurit ose të lënduarit në fushëbetejë, ndërsa Kursi i Lidershipit Reagues është një trajnim sfidues që ka për qëllim të nxjerr në pah aftësitë udhëheqëse të pjesëtarëve të cilët prezantojnë njohuri dhe shkathtësi për të drejtuar njësitet e tyre, në zgjidhjen e situatave dhe kapërcimin e pengesave gjatë operacioneve apo situatave të ndryshme që kërkojnë sakrificë për t'u përballur me kërcënime serioze për të përmbushur misionin, tha në fund gjeneral Cikaqi.

Major Mathew Kuhnle, instruktor i trajnimit, në emër të Ekipit Luftarak Shumëkombësh-Lindje, tha:" Dëshiroj të them se ka qenë kënaqësi dhe nder të jem në Kosovë dhe të punojë krah - për krah me pjesëtarët e FSK-së, ku entuziazmi dhe dëshira e tyre për të mësuar ka qenë inspiruese", tha në fund, majori Matheë Kuhnle.

Shefi i Shtabit të NLAT-it, kolonel Michele Biasiutti, në fjalën e tij, tha: " FSK-ja me këto trajnime është duke përparuar çdo ditë e më shumë dhe kjo na bënë të ndjehemi mirë dhe të mendojmë se sukseset e FSK-së, janë suksese të përbashkëta. Ne po vërejmë se FSK çdo ditë po avancohet në lëmin e trajnimeve të ndryshme, ndërsa këto janë disa nga trajnimet kryesore që duhet trajnuar pjesëtarët e FSK-së".

Një fjalë e mbajti edhe shefi i Shtabit të Bondstill, nënkolonel Chadwick Shields i cili ndër të tjera, tha: "Lidershipi rrit efektin në fushëbetejë, sinkronizon organizatat, mundëson komunikimin, ofrojnë qëllim, drejtim dhe motivim. Stërvitja e lidershipit në mos e treta është njëra nga detyrat themelore të secilës ushtri". Roli dhe rëndësia e reaguesve të parë në fushëbetejë dhe lidershipit reagues është aq i rëndësishëm sa që nga kjo varet edhe jeta e ushtarëve nëpër beteja.

Në fund u ndanë certifikata për pjesëtarët e FSK-së dhe instruktorët amerikan.

Ushtrimi fushor "Ujku 1A në Veprim" realizohet me sukses nga Kompania 1A e Batalionit të Parë për Reagim të Shpejtë

Kompania 1A e Batalionit të Parë për Reagim të Shpejtë në Gjilan, nga data 23-25 shtator 2014, ka realizuar ushtrimin fushor të koduar "Ujku 1A në Veprim"

Qëllimi i mbajtjes së ushtrimit fushor "Ujku 1A në Veprim" ishte vlerësimi i gatishmërisë operacionale të Kompanisë model (K1A).



Pas arritjes së Kapaciteteve të Plota Operacionale dhe bazuar në direktivat e komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), për trajnimin e kompanive si forcë e kombinuar për reagim ndaj krizave dhe fatkeqësive natyrore, dhe me qëllim të vlerësimit të aftësisë së K1A, ka qenë i angazhuar një ekip i ushtrisë amerikane i cili e ka përcjellë nga afër ushtrimin me qëllim të vlerësimit të Kompanisë 1A të Batalionit të Parë të BRSH-së.

Ushtrimi fushor "Ujku 1A në Veprim" është realizuar në regjionin e Komunës së Vitisë, kryesisht në terrenet e fshatrave të kësaj komune: Letnicë, Shoshare, Vrellë, Petrinoviq, Veselicë. Kompania 1A, gjatë



mbajtjes së ushtrimi fushor, ka realizuar me sukses; planifikimin e operacionit, komunikimin, vëzhgimin e terrenit, mbrojtjen e marshit rrugor, pikën e kontrollit, perimetrin e sigurisë, vijën në veprim dhe vijën rrethore, si dhe koordinimin me njësitë tjera të FSK-së dhe autoritetet lokale. Ushtrimi është zhvilluar duke u fokusuar në realizimin e detyrave në përputhje me misionin, ku kompanitë kishin mundësi t'i realizojnë detyrat me skenarë të ndryshëm nga forcat opozitare të cilat ishin në kuadër të ushtrimit. Në fund, sipas vlerësimit të përgjithshëm, del se Kompania 1A e Batalionit të Parë, me sukses ka realizuar ushtrimin fushor "Ujku 1A në Veprim".

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, dekoroi nënkolonel Prokshin me medaljen "Shërbim Meritor"



Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore, në Prishtinë, më 26 shtator 2014, u mbajt ceremonia lamtumirëse, me rastin e pensionimit të komandantit të Batalionit të Xhenios nënkolonel Zjenullah Prokshi.

Në këtë ceremoni, morën pjesë: ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, sekretari i përgjithshëm i FSK-së, z. Shkëlzen Sylaj , komandanti i Brigadës Mbështetëse Operacionale, gjeneral Brigade Ilaz Derguti, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri si dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kadri Kastrati në fjalën e tij përshëndetëse, tha: "Nënkolonel Zejnullah Prokshi gjatë kohës sa ka shërbyer në FSK, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen dhe profesionalizimin e saj. Batalioni i Xhenios, gjatë kësaj periudhë ka kryer punë jashtëzakonisht të mëdha, dhe një prej arsyeve pse FSK-ja është institucioni më i besueshëm dhe më i respektueshëm në Kosovë është meritë edhe nënkolonel Prokshit. Batalioni i Xhenios të cilin e ka udhëhequr nënkolonel Prokshi , ka pasur rolin kryesor në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati e dekoroi nënkolonel Zejnullah Prokshin, me medaljen për "Shërbim Meritor" me motivacionin: "Për kontributin e dhënë në ngritjen e FSK-së".

"Për neve, si FSK, shkuarja në pension e nënkolonel Prokshit, do jetë një humbje, pasi që Ai, nuk do jetë më aktiv, mirëpo Zejnullah Prokshi duhet të jetë krenar për të arriturat e deritashme të FSK-së dhe për të ardhmen e saj të çartë drejt transformimit në Forca të Armatosura të Kosovës, gjë për të cilën edhe nënkolonel Prokshi ka dhënë një kontribut mjaft të lart", tha në fund komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati.

Intervistë me nënkolonel Zejnullah Prokshin, ish-komandant i Batalionit të Xhenios të FSK-së

E ardhmja e FSK-së është në mesin e ushtrive moderne botërore dhe pjesë e NATO-s, si partner i besueshëm i saj

Gazeta "Forca Jonë" : Zoti nënkolonel, Ju ishit pjesëtar i UÇK-së, TMK-së dhe i FSK-së, çfarë mund të na thoni për këtë periudhë kohore, që keni shërbyer deri më sot?

Nënkolonel Zejnullah Prokshi: Së pari dua të them një të vërtet; për asnjë çast të jetës sime, nuk do t'i harroj ditët e lavdishme në shërbim të vendit dhe të lirisë së popullit tim, pra nuk do t'i harroj ditët, muajt e vitet që i kalova në radhët e UÇK-së. Dhe ndjehem shumë krenar që isha ushtar i Komandantit Legjendar Adem Jashari. Të gjithë shokët që ishim bashkë në luftë i çmoj dhe i dua shumë, edhe pse shumë prej tyre, sot, nuk janë në mesin tonë. Të gjithë bëmë atë që mundem dhe që duhej bërë për atdhe. Në të gjallët, ia kemi paguar vetëm një pjesë të borxhit atdheut, kurse dëshmorët, gjaku i tyre, mundi e sakrifica e të gjithëve janë dhe do mbesin gurë themel i atdheut tonë të shtrenjtë.



Ndërsa, vitet e shërbimi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) ishin vite krenarie, ku tashmë po i shërbeja popullit tim në ditët e lirisë, por edhe dhembja për shokët e rënë ishte gjithnjë e pranishme. Nga periudha e shërbimit në TMK kam kujtime shumë të mira. Kemi ndjekur shumë trajnime të ndryshme dhe për një periudhë të shkurtër, gati jemi renditur me ushtritë moderne të shteteve me traditë ushtarake. Çdo gjë që na është kërkuar e kemi bërë .

Kurse në FSK, që do të vazhdoj ta ndjej vetën si pjesë të saj, kam kujtime që nuk do t'i harroj asnjëherë. Edhe pse në pritje të zyrtarizmit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës, jam shumë i lumtur qe erdhi koha që së shpejti të jemi ushtri e barabartë me të gjithë në Rajon dhe më gjerë.

Gazeta "Forca Jonë": Në FSK u pranuat me gradën nënkolonel dhe keni qenë komandant i Batalionit të Xhenios, cilat janë përvojat e tuaja gjatë kësaj kohe?

Nënkolonel Zejnullah Prokshi: Po është e vërtet, nga kalimi apo transferimi i TMK-së në FSK, unë u pranova me gradën nënkolonel në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe besoj së e mbajta atë gradë ushtarake me dinjitet. Pastaj, më emëruan komandant i Batalionit të Xhenios, ku edhe aty e kreva detyrën time, prej komandanti, ashtu siç e kërkonte rregulli dhe ligjet ushtarake. Mund të them se nga shërbimi në FSK kam mësuar shumë dhe do të më mbesin vetëm kujtime të mira.

Gazeta "Forca Jonë" : *Si ndjeheni tani, pas kaq vitesh në uniformë dhe sa jeni i kënaqur me të arriturat e deritanishme të FSK-së?*

Nënkolonel Zejnullah Prokshi: Unë nuk dua dhe nuk me takon të flas për të arriturat e mia personale, kryesorja është së kemi arritur si kolektiv. Kemi qenë dhe mbetemi institucioni më i besueshëm i Kosovës. Nuk mund ta mohoj faktin se gjithmonë me ka pëlqyer uniforma dhe besoi se deri këtu e kam bartë me nder dhe dinjitet. Jam krenar për të gjitha detyrat dhe veprimet që kamë bërë deri më tani. Ata që me njohin mund të thonë më shumë se kaq.

Gazeta "Forca Jonë": Si e shihni veten pas pensionimit tuaj dhe ku e sheh FSK-në në të ardhmen?

Nënkolonel Zejnullah Prokshi: Thënë të drejtën, hapi më i rëndësishëm dhe më i duhur për të ardhmen e FSK-së, është që sa më parë dhe pa humbur as edhe një ditë të vetme, të krijohen (ndërkombëtarizohet) Forcat e Armatosura të Kosovës, sepse të gjitha kushtet që kërkohen janë plotësuar, këtë e thonë dhe e pranojnë edhe faktorët (ekspertët) ndërkombëtarë, prandaj e them dhe jam i sigurt së e ardhmja e FSK-së, është në mesin e ushtrive moderne botërore dhe pjesë e NATO-s, si partner i besueshëm i saj.

Kurse, për sa i përket pensionimit, koha e bën të vetën. Duhet t' u jepet rasti edhe të tjerëve që të udhëhequn më njësi. Jeta sigurisht që duhet të vazhdojë. Unë do t'i qasem jetës civile dhe do të vazhdojë t'i rri besnik familjes sime, shokëve, miqve e dashamirëve. Asnjëherë nuk do t'i harroj, por do t'i respektoj ata dhe familjet e tyre.

Instruktorë amerikanë trajnojnë oficerët dhe nënoficerët e BRSH-së në Istog



Në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunimin bilateral në mes të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Gardës Kombëtare të Iowa-s (SHBA), nga data 08-28 shtator 2014, në Kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, po qëndron një ekip ekspertësh ushtarak të fushave të ndryshme të Ushtrisë Amerikane dhe të Gardës Kombëtare(GK) të Iowa-s.

Qëllimi i qëndrimit të ekspertëve ushtarak amerikanë është mbështetja për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe të Brigadës për Reagim të Shpejtë, duke ofruar përvoja dhe njohuri të ndryshme, përmes organizimit të seminareve dhe punëtorive të ndryshme, që janë duke u realizuar në BRSH, gjithashtu do të monitorojnë nga afër realizimin e ushtrimeve fushore në nivel Kompanie, në Batalionet e Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe do bëjnë vlerësimin e tyre, po ashtu do të monitorojnë realizimin e ushtrimeve në Vendkomandë (UVK) të tri Batalioneve të BRSH-së.

Ekipi i ushtarakëve amerikan kanë filluar mbajtjen e seminareve dhe punëtorive në Kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, me tema të ndryshme, si: Komunikim, Logjistikë, Mbështetje, Procedurat e Marrjes së Vendimeve Ushtarake, Procedurat e Udhëheqjes së Trupave, etj. Pjesëmarrësit në këto seminare janë oficerë dhe nënoficerë të niveleve dhe detyrave të ndryshme, nga Komanda e BRSH-së, Komandat e Batalioneve dhe të Kompanive.

Të gjitha njohurit dhe përvojat e marra nga instruktorët amerikan do të realizohen dhe testohen

Kompania e Tretë "C"e BRSH-së përmbylli trajnimin 4 mujor me finalizimin e ushtrimit fushor "Veprimi i Shpejtë-2"

Në bazë të kalendarit vjetor të stërvitjes të Batalionit Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, Kompania 3C, ka realizuar një trajnimin katër mujor me Ekipin Trajnues Turk (ETT). Ushtrimi ka filluar të mbahet më 12 maj 2014 dhe ka përfunduar, më 10 shtator 2014, trajnim ky, i cili u përmbyll me ushtrimin fushor "Veprimi i Shpejtë- 2"

Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë 136 pjesëtarë me 26 automjete. Gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e Kompanisë 3C dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht në operacionet ushtarake, siç janë: patrullimet, pritat, kërkim-shpëtim dhe kordon, baza patrulluese, rikonicion të terrenit, reagim në kontakt me armikun, sulm në nivel togu, shkëputje të kontaktit, pika të kontrollit dhe fusha tjera.

Po ashtu, gjatë këtij ushtrimi, pjesëtarët e Kompanisë 3 C janë sfiduar fizikisht me patrullime natën dhe ditën, navigim tokësor, lëvizje në terren të thyeshëm me vegjetacion të dendur dhe tema tjera ushtarake, ku treguan vendosmëri dhe moral të lartë për realizimin e misionit.

Gjatë planifikimit dhe zbatimit të këtij ushtrimi fushor, çdo detaj ka funksionuar në bazë të Procedurës së Udhëheqjes së Trupave.

Ushtrimi fushor është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Tretë dhe u zbatua në nivel Kompanie, nga data 08 deri më 10 shtator 2014.

Vlen të theksohet se ky ushtrim është vlerësuar për herë të parë në bazë të standardit të ri (NATO) për vlerësimin e ushtrimeve nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) dhe nga ushtarakë të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të N-LAT.



Komandanti i FSK-së e nderoi me mirënjohje rreshter majorin amerikan, Allen Dahl

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në takimin lamtumirës, organizuar për rreshter majorin amerikan Allen Dahl, tha: "zhvillimi i trupës së nënoficerëve është njëri ndër prioritetet e mija" dhe një kontribut të çmueshëm në këtë drejtim e ka dhënë edhe rreshter majori Allen Dahl, të cilin e falënderoi për kontributin dhe për angazhimin e tij, gjatë dy viteve në FSK.


Gjeneral Kastrati në shenjë respekti për punën dhe angazhimin e tij, i dha Mirënjohje dhe Medaljonin e tij personal.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati shprehi mirënjohje për Ambasadën e SHBA-ve, Zyrën për Bashkëpunimit dhe Mbrojtje dhe Gardën Kombëtare të Ajovës, për kontributin e vazhdueshëm që po japin në zhvillimin dhe ngritjen profesionale të FSK-së.

Rreshter majori i FSK-së, Genc Metaj, i cili ka punuar së bashku me rreshter majorin amerikan, tha, se rreshter major Dahl, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm me angazhimin e tij profesional edhe përmes këshillave, sugjerimeve dhe propozimeve të cilat kanë ndikuar në mënyrë pozitive në zhvillimin e trupës së nënoficerëve dhe në sistemin e edukimit në përgjithësi.

Ndërsa, rreshter majori Allen Dahl, shtoi






se është shumë i impresionuar dhe i kënaqur me përparimet e bëra në FSK, dhe falënderoi të gjithë për bashkëpunim e mirë dhe mikpritjen. Ai, tha, se pas kthimit në Amerikë, do të angazhohet në Kampin Dodge, në Ajova, dhe, nga këtu premtoi vazhdimin e bashkëpunimit me FSK-në, në suaza të programit të partneritetit shtetëror të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës.



FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 29 • Nëntor 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri Çeku në Konferencën Karta e Adriatikut A-5



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Agim Çeku, mori pjesë në Konferencën e Ministrave të Mbrojtjes të Ballkanit, "Karta e Adriatikut A -5", e cila u mbajt në qytetin e Budvës në Mal të Zi, më 15,16 dhe 17 tetor 2014. Temë kryesore e diskutimit në këtë takim ishte forcimi i bashkëpunimit midis vendeve pjesëmarrëse në këtë nismë në funksion të stabilitetit dhe sigurisë së rajonit përballë zhvillimeve të rëndësishme gjeopolitike. Në kuadër të kësaj konference morën pjesë ministrat e Mbrojtjes të Kroacisë, Turqisë, Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi, si dhe përfaqësuese të NATO-s dhe të SHBA-ve. Ministri i MFSK-së, Agim Çeku në ditën e dytë të konferencës, më: 16 tetor 2014, takoi z. Jonathan Parish zëvendës asistent i Sekretarit të Përgjithshëm për Mbrojtje, Politika dhe Plane në NATO, të cilin ministri Çeku e njoftoi me zhvillimet e përgjithshme të FSK-së, si dhe biseduan për gatishmërinë e FSK-së për të zhvilluar më tej, misionin dhe strukturën e saj, si dhe për gjendjen politike në vend. Të dy palët shprehën vullnetin për vazhdimin e bashkëpunimit strategjik edhe në të ardhmen. Ministri Çeku po ashtu realizoi një varg takimesh me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, z. Zoran Jolevski, ministrin e Kroacisë, z. Ante Kotromanovic, znj. Mimi Kodheli ministre e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, z. Ismet Yilmaz ministër i Mbrojtjes së Turqisë, Milica Pejanovic-Durisic ministre e Mbrojtjes të Malit të Zi, etj. Gjatë këtyre takimeve ministrat shkëmbyen mendime rreth zhvillimeve aktuale në fushën e Mbrojtjes, si dhe për çështje të tjera që i shërbejnë forcimit të bashkëpunimit midis shteteve. Gjatë takimit ministri Çeku dhe ministri i Mbrojtjes së Turqisë, z. ?smet Ylmaz, vlerësuan bashkëpunimin dhe marrëdhëniet mes dy vendeve dhe ushtrive, si dhe nënshkruan protokollin e bashkëpunimit. Ministri Çeku, me homologët e tij, bisedoi për tema me interes për rajonin, gjithashtu diskutuan edhe për vullnetin e përbashkët për të thelluar marrëdhëniet bilaterale, si dhe identifikimin e sfidave të përbashkëta në sferën e sigurisë së përgjithshme jo vetëm rajonale por edhe globale.

Në prezantimin e tij, ministri Agim Çeku, me theks të veçantë foli rreth përgatitjeve për t'u ballafaquar me sfidat e reja të sigurisë globale, të cilat siç tha ai, sot, kanë marr trajtë tjetër nga kërcënimet tradicionale të sigurisë. Ai përmendi se në botën e globalizuar po ballafaqohet me kërcënime si terrorizmi ndërkombëtar, krimi i organizuar, shitja e armëve të lehta në tregje të zeza, kërcënimi kibernetikë dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, tha ministri Çeku, gjatë rishikimit të fundit të sektorit të sigurisë, Kosova ka ndërmarr hapa konkret në vlerësimin e rreziqeve të tilla dhe ka përgatitur edhe rekomandime për ngritjen e kapaciteteve ekzistuese në mënyrë që sa më mirë të menaxhohen këto rreziqe". Duke përfunduar fjalën e tij, ministri Agim Çeku tha:" Kosova sikurse edhe vendet anëtare të Karta e Adriatiku A- 5", kanë aspirata dhe qëllime të njëjta që të jetë mbështetës aktiv dhe kontribuuese për sigurinë Euro-Atlantike. Në ditën e fundit të konferencës "Karta e Adriatikut A-5", ministri i FSK-së, Agim Çeku pati edhe një takim me z. Evelyn Farkas zëvendës asistente e sekretarit të Mbrojtjes të SHBA-ve, për Euro Azi, si dhe u prit nga kryeministri i Malit të zi, z. Milo Gjukanoviq. Në fund të konferencës "Karta e Adriatikut A-5" të pranishmit dolën me një deklaratë të përbashkët përmes së cilës shprehën vendosmërinë e tyre për të inkurajuar paqen, stabilitetin, duke bashkëpunuar ngushtë me aleatët strategjikë, si në aspektin politik ashtu dhe në fushën e Mbrojtjes.

Delegacioni i NATO-s u prit nga ministri i FSK-së, z. Agim Çeku

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin dhe sekretarin e përhershëm Shkëlzen Sylaj, më 2 tetor 2014, pritën në ambientet e Ministrisë së FSK-së, një delegacion të NATO-s, të prirë nga z. Richard Froh, zëvendës asistent i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për operacione.

Temë e takimit të sotëm ishte vazhdimi dhe thëllimi i bashkëpunimit të mëtejmë ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe NATO-s.

Ministri Çeku, me këtë rast, falënderoi NATO-n për mbështetjen e



përgjithshme që ata po japin në ngritjen profesionale të FSK-së, si dhe e njoftoi z. Froh me të arriturat e përgjithshme, perspektivën e FSK-së dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë.

FSK me sukses përmbylli ciklin e ushtrimeve "Shqiponja 3"

Pas përmbylljes me sukses të ciklit të ushtrimit fushor "Shqiponja 3", përmes të cilit u bë testimi i kapaciteteve operacionale të Brigadës për Mbështetje Operacionale dhe njësive pranë shtabore të Komandës së Forcave Tokësore KFT) të Forcës së Sigurisë. *Vijon në faqen 4-5,*



Konferencë e përbashkët bashkëpunimi FSK dhe partnerët

Në ambientet e reja të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, më 30 tetor 2014, u mbajt Konferenca e përbashkët e bashkëpunimit FSK dhe partnerët, në të cilën morën pjesë: ministri i MFSK-së, z. Agim Çeku, zëvendësministrat Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, oficerë dhe zyrtarë të lartë të MFSK-së, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Peter Braunstein, drejtori i NAT-it, z. Kevin Lynch, përfaqësues të ambasadës amerikane, atashetë ushtarak të akreditуar në Kosovë, përfaqësues të NATO-s, të NLAT-it, si dhe përfaqësues ushtarak të ushtrive të regjionit, etj. Punimet e konferencës i hapi kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë për FSK-në. Në konferencën e përbashkët për bashkëpunim me partnerët u mbajtën tri referenca-prezantime: Procesi i implementimit dhe planifikimit strategjik në MFSK pas rekomandimeve të RSSS-së, Procesi i planifikimit operacional, prioritet dhe koncepti i trajnimit dhe e treta, Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Ministri i MFSK-së, z. Agim Çeku me këtë rast, përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit si dhe falënderoi për ndihmën e vazhdueshme që kanë dhënë dhe po japin për ngritjen profesionale të FSK-së dhe zhvillimit dhe transformimit të saj në Forcat e Armatosura të Kosovës. Ne jemi duke punuar shumë në kuadër të misionit aktual të FSK-së si dhe në planifikimin e ngritjes së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Kosovës. Parim i ynë i bashkëpunimit është transparenca me të gjithë partnerët tanë si dhe me qytetarët. Në fund të fjalës së tij, ministri Çeku, tha: "Ne e dimë vlerën e ndihmës tuaj, sukseset i kemi arritur së bashku me ju, po ashtu edhe në të ardhmen kemi nevojë për mbështetjen tuaj si partnerë dhe anëtar të NATO-s".

Me nga një referencë, më pastaj u paraqiten, gjeneral brigade Peter Braunstein, drejtori i NLAT-it, (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s), oficeri i Ushtrisë Amerikane Robert Matthewson me mision në NATO, Kevin Lynch, drejtori i NAT (Ekipit Këshillues të NATO-s) etj.

Konferenca i vazhdoi punimet me referimet për temat: Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë, Planifikimi i operacioneve, trajnimeve dhe zhvillimi i njësive dhe Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Pas punimeve të Konferencës pritet të thellohet dhe konkretizohet edhe më tej bashkëpunimi me partnerët tanë ndërkombëtar, NATO-n dhe vendet e regjionit në të mirë të sigurisë së përgjithshme.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku priti ambasadoren e Francës, znj. Maryse Daviet

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK-së) z. Agim Çeku më, 20 tetor 2014, priti në ambientet e reja të Ministrisë të FSK-së, ambasadoren e Francës në Kosovë, znj. Maryse Daviet të cilën e njoftoi me të arriturat e deritanishme të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai, me këtë rast, e ka falënderuar ambasadoren e Francës, znj. Daviet për bashkëpunimin ndërmjet të dyja vendeve, me theks të veçantë për ndihmën për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ndërkaq, ambasadorja e Francës znj. Maryse Daviet falënderoi ministrin Çeku, për pritjen dhe premtoi angazhimin e saj edhe në të ardhmen, për vazhdimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit në mes dyja vendeve dhe dy ministrive përkatëse.

Shefi i Shtabit të FA të Shqipërisë me nderime ushtarake priti komandantin e FSK-së




Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me bashkëpunëtorë, më 13 tetor 2014, vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
Komandanti i FSK-së u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të Shqipërisë, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Për nder të komandantit të FSK-së, ishte rreshtuar Garda e Nderit të FA të Shqipërisë. Në ceremoninë e pritjes që u organizua për nder të gjeneral Kastratit morën pjesë edhe ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, stafi i lartë i FA të Shqipërisë, gjeneral brigade Enver Cikaqi nga FSK-ja dhe atasheu ushtarak i Kosovës në Tiranë, nënkolonel Enver Dugolli. Gjatë takimit u shpreh dimensioni i shtuar i bashkëpunimit të Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, në të gjitha fushat si dhe në fushën kulturore-sportive. Në këtë kuadër, ekipi i futbollit të FSK-së, ndodhej në Tiranë për ndeshjen e kthimit në mes ekipeve të FA të Shqipërisë dhe FSK-së. Të dy gjeneralët e njoftuan njëri-tjetrin me zhvillimet më të fundit në strukturat e tyre përkatëse, si dhe parashtruan objektivat e punës së tyre për të ardhmen e afërt dhe afatgjate të FSK-së dhe FARSH-së. Ata gjithashtu vlerësuan nivelin e bashkëpunimit midis dy strukturave dhe ndanë të njëjtin mendim për ta thelluar këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen në të gjitha fushat. Gjeneral Bazo shprehu angazhimin e tij personal dhe të FARSH-së, për t'i ofruar FSK-së asistencën dhe mbështetjen e nevojshme për arritjen e objektivit të saj madhor si pjesë e objektivit të Kosovës- anëtarësimi në NATO. Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, në fund të vizitës, qëndroi edhe në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë, ku u prit nga ambasadori Ramiz Lladrovci dhe atasheu i Kosovës nënkolonel Enver Dugolli.

Oficerë të Akademisë Ushtarake të FARSH-së vizituan FSK-në



Në kuadër të një vizite pune, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, qëndroi një delegacion i oficerëve (kolonel-nënkolonel) të kursit të lartë për Siguri dhe Mbrojtje të Akademisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (Kurs i licencuar nga NATO), të cilin kurs po e ndjekin oficerë nga: Turqia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova.
Oficerët e kursit të lartë, në ambientet e Ministrisë së FSK-së, i priti komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrti i cili i njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, shkollimin, plotësimin e kapaciteteve operacionale, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal, bashkëpunimin me NATO-n, Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe objektivat për të ardhmen. Ndërsa, kolonel Skënder Hoxha nga Departamenti i Operativës dhe Trajnimeve, përmes një prezantimi të përgjithshëm i njoftoi oficerët e kursit të lartë me misionin e FSK-së, strukturën, aktivitetet, intervenimet e njësisë së kërkim-shpëtimit, deminimit si dhe realizimin e projekteve humanitare, trajnimet e jashtme dhe të brendshme dhe pjesëmarrjen e FSK-së në stërvitjet brenda dhe jashtë shtetit. Në emër të oficerëve të kursit të lartë, komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin, e falënderoi komandanti i Akademisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë kolonel Idriz Haxhia.

Zëvendësministri Latifi dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati përcollën ushtrimin në vendkomandë "Shqiponja 3"



Në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, u mbajt një takim i shkurtër informues në lidhje me ushtrimin e FSK-së në vendkomandë të koduar me emrin "Shqiponja-3".
Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, përshëndeti pjesëtarët e FSK-në, për realizimin me sukses të këtij ushtrim, KFOR-in, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), NLAT-in, atashetë ushtarak, instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës, për ndihmën profesionale. Gjeneral Kastrati, me këtë rast tha:" Stërvitja e pjesëtarëve dhe njësiteve të FSK-së, është objektiv dhe prioritet i yni dhe i komandantëve në të gjitha nivelet. Ushtrimi në vendkomandë ,,Shqiponja 3" është finalizim i suksesshëm i ciklit të stërvitjeve individuale dhe kolektive të FSK-së, për këtë vit. FSK-ja me seriozitetin dhe angazhimin maksimal ka dëshmuar se është institucioni më i besueshëm në Kosovë.
Në fund, gjeneral Kastrati duke falënderuar edhe një herë partnerët ndërkombëtarë, shtoi: "Pjesë e suksesit tonë janë padyshim edhe partnerët tanë ndërkombëtarë, që po na ndihmojnë profesionalisht gjatë realizmit të trajnimeve të FSK-së".
Ndërsa, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri e njoftoi zëvendësministrin e MFSK-së, z. Latifi, komandantin e FSK-së, gjeneral Kastratin si dhe mysafirët e lartë, me skenarin dhe objektivat e trajnimit në vendkomandë "Shqiponja 3". Kolonel Haziri, tha:" Ushtrimi ka filluar të realizohet më 13 tetor 2014 dhe do të vazhdojë deri më 17 tetor 2014. Qëllimi i ushtrimit në vendkomandë "Shqiponja 3" është që të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të njësive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren".
Për të përcjellë nga afër ushtrimin e FSK-së në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj kishin ardhur: zëvendësministri i FSK-së; z. Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Enver Cikaqi, përfaqësues të KFOR-it, shefi i NLAT-it, gjeneral brigade Peter Braunstein, atashe ushtarak të akreditуar në Prishtinë, përfaqësues të Agresionit për Siguri dhe të Policisë së Kosovës si dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Gjeneral Kastrati takoi një delegacion të Ushtrisë Amerikane

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 24 tetor 2014, priti në ambientet e Ministrisë, në një takim pune një delegacionin të Ushtrisë Amerikane dhe të Gardës Kombëtare të Iowas, të prirë nga rreshter majori Rachel Fails si dhe dy udhëheqësit e ekipeve trajnuese që gjenden në Kosovë, më saktësisht në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, nënkolonel Higinbotham nga Iowa dhe Shefin Williams nga Ushtria Amerikane. Në takim mori pjesë edhe atasheu i Mbrojtjes në Ambasadën e Amerikës në Kosovë, koloneli Chad Butts.
Trajnimet që po mbahen në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, nga ekipet amerikane, janë: Kursi për paramedikë- dhënia e ndihmës së parë dhe Kursi për vëzhgues kontrollues. Në takim është biseduar për ecurinë e trajnimeve nga këto ekipe, angazhimin e pjesëtarëve të FSK-së, si dhe punën që po zhvillohet në këto kurse. Gjithashtu u bisedua edhe për bashkëpunimin dhe partneritetin në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Iowas dhe Ushtrisë Amerikane.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Zëvendësministri Gashi mori pjesë në Konferencën ndërkombëtare "Mbrojtja e mençur, ndarje, bashkim dhe iniciativë", në Strugë



Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë, zotëri Bejtush Gashi dhe drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, zotëri Faruk Geci morën pjesë në Konferencen ndërkombëtare "Mbrojtja e mençur, ndarje, bashkimin dhe Iniciativ - Mundësitë dhe Drejtimet", mbështetur nga Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s, organizuar nga Këshilli euro-atlantik i Maqedoninë që u zhvillua nga data: 17 - 19. 10. 2014 në Strugë, të Republikës së Maqedonisë.

Në Konference u diskutuan pikëpamjet kombëtare dhe mendime për çështjet tematike të lidhura dhe për të ofruar rekomandime për SHBA - Kombet e Kartës së Adriatikut plus kombeve të interesuara për anëtarësim në kuadër të "Adriatik 5"për zhvillimin e ardhshëm të qasjes rajonale "Mbrojtja inteligjente", si dhe mundësitë e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral.

Duke marrë parasysh burimet e kufizuara kombëtare dhe sfidat e buxhetit, konferenca doli me rekomandime që vendet e rajonit mund të bashkojnë forcat dhe burimet për të zbatuar projekte efektive. Delegacioni i Republikës së Kosovës shprehu gatishmërinë përpër bashkimin e forcave dhe burimeve për të zbatuar projekte efektive, duke ofruar projekte me interes të përbashkët, për të gjithë rajonin sidomos ne fushën e emergjencave civile.

Zëvendës ambasadorja e Mbretërisë së Bashkuar vizitoi Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj



Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi me bashkëpunëtorë, priti në një takim pune, zëvendës ambasadoren e Mbretërisë së Bashkuar, znj. Louise Taylor, e akreditуar në Prishtinë.

Me këtë rast, gjeneral Cikaqi e falënderoi zëvendës ambasadoren znj. Taylor, për ndihmën e vazhdueshme që po jep Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe ambasada e saj në Prishtinë për FSK-në, përmes trajnimeve të shumta për oficerët e saj. Po ashtu e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes si dhe me sfidat me të cilat ata po ballafaqohen gjatë realizimit të detyrave.

"Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar ka luajtur një rol kyç në trajnimin e oficerëve të FSK-së, edhe në Akademinë ushtarake SANDHURST" në Londër. FSK-ja çdo ditë e më shumë po përgatit kuadro me programe standarde të përfituara nga vendet anëtare të NATO-s, dhe këto njohuri jemi duke i vënë në funksion të avancimit dhe përparimit me qëllim që të kemi trajnime unike në të gjitha njësitë. Edhe ky takim është në frymën e bashkëpunimit dhe ndihmës së dhënë për FSK-në, ku pjesëtarë të FSK-së do të përfitojnë nga ky program i shkollimit" tha gjeneral Cikaqi.

Ndërsa, zëvendës ambasadorja Taylor, falënderoi komandantin e KDS-së, gjeneral Cikaqin, dhe u shpreh se ndjehet e lumtur me të arriturat që po sheh kudo në FSK dhe njëherësh premtoi thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

Ambasadori i Shqipërisë, Qemajl Minxhozi, vizitoi FSK-në



Zëvendësministri i MFSK-së, z. Bejush Gashi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin, pritën sot, në takime të ndara, ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemajl Mingjozi.

Zv.ministri Gashi dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati e njoftuan ambasadorin Mingjozi me të arriturat e përgjithshme të Ministrisë dhe FSK-së, duke çmuar lartë bashkëpunimin e deritanishëm me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë.

Me këtë rast, zëvendësministri Gashi dhe komandanti i FSK-së, shprehen gatishmërinë e tyre për të thelluar dhe intensifikuar bashkëpunimin, duke ofruar mundësi dhe vullnet për bashkëpunim në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Zëvendësministri Gashi e informoi ambasadorin Mingjozi edhe për proceset aktuale të zhvillimit në FSK, objektivat si dhe për procesin e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë në Kosovë (RSSSK).

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Mingjozi, pasi falënderoi për pritjen dhe bashkëpunimin, shprehu gatishmërinë e tij personale për të kontribuar në shtimin e këtij bashkëpunimi në mes dy ministrive, përkatësisht në mes Ushtrisë së Shqipërisë dhe FSK-së, në të gjitha fushat.

Sekretari i MFSK-së priti ambasadorin e Suedisë

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, i shoqëruar nga drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s, z. Kevin Linç, si dhe zyrtarët e MFSK-së Sinan Geci dhe Florin Hoxha, më 9 tetor 2014, priti në një takim pune, zotin Mats Nystrom, zëvendësdrejtor i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Suedisë përgjegjës për Kosovën, i cili shoqërohej edhe nga i ngarkuari me punë i Ambasadës së Suedisë në Kosovë, z. Henrik Nilson si dhe Kurt Gjakobson, oficer ndërlidhës në Ambasadën suedeze. Me këtë rast Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Sylaj, e falënderoi zëvendësdrejtorin Nystrom për ndihmën që po jep Suedia për FSK-në si dhe e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Gjatë takimit theks i veçantë u vu në thellimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët që dalin edhe nga Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar mes dy ministrive përkatëse; Ministrisë së Mbrojtjes të Suedisë dhe MFSK-së.

Si vazhdim i bashkëpunimit dhe përkrahjes së MFSK - së edhe më tutje me këshilltarë në kuadër të Ekipeve Këshilluese të NATO-s.

Përkrahja në ngritjen dhe zhvillimin e Njësisë së Kërkim- Shpëtimit duke kontribuar edhe në ngritjen e Qendrës së Trajnimit për këtë njësi.

Përkrahja në fushën e deminimit të hapësirave të minuara, në veçanti në objektet e rrënuara, ku FSK-ja ka nevojë për teknikë dhe pajisje të veçanta për deminim. Në këtë drejtim u vlerësua lartë bashkëpunimi në deminimin e objekteve të bombarduara në Parkun e Gërmisë në Prishtinë.

Njoftimi me konkluzionet e veçanta të dala nga Rishikimi i Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës e me theks të posaçëm për FSK-në, përgatitjet për themelimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe krijimin e Forcave të Armatosura.

Delegacioni nga Suedia edhe njëherë rikonfirmoi përkrahjen e Suedisë edhe në të ardhmen për Ministrinë e FSK-së.



Marrëveshje bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Doganës së Kosovës

Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj më 30 tetor 2014, priti drejtorin e Doganës së Kosovës, z. Lulzim Rafunën me të cilën nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Doganës së Kosovës. Qëllimi i nënshkrimit të kësaj marrëveshje është thellimi i bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve shumë të rëndësishme të Kosovës. Me këtë rast, Ministria e FSK-së i dha në shfrytëzim dy kontejnerë dykatëshe Doganës së Kosovës pa kompensim, për pesë vjet. Marrëveshjen në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës e nënshkroi Sekretari i Përgjithshëm, z. Shkëlzen Sylaj ndërsa për Doganat e Kosovës drejtori i saj, z. Lulzim Rafuna.



Përfundoi Ushtrimi fushor "Shqiponja 3"

FSK-ja e gatshme t'i zbatojë detyrat që i kërkohen nga institucionet qendrore

Në ambientet e ish-kazermës së FSK-së në Pejë, më 23 tetor 2014, u përmbyll me sukses cikli i ushtrimit "Shqiponja 3", përmes të cilit u bë testimi i kapaciteteve operacionale të Brigadës për Mbështetje Operacionale dhe njësive pranë shtabore të Komandës së Forcave Tokësore KFT) të Forcës së Sigurisë.
Në Komandën e vend incidentit të ushtrimit "Shqiponja 3", prezantimin për rrjedhën e përgjithshme të operacioneve para ministrit, komandantit dhe eprorëve të lartë e bëri drejtori i këtij ushtrimit, kolonel Naim Haziri, shef i Shtabit të KFT-së.
Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili vizitoi operacionet përfundimtare të ushtrimit, i përgëzoi veçanërisht ushtarët, nënoficerët dhe oficerët të cilët treguan profesionalizëm, vullnet dhe disiplinë për të realizuar të gjitha objektivat e parashikuara të ushtrimit fushor "Shqiponja 3". Ai, me këtë rast, tha: "Stërvitja e pjesëtarëve dhe e njësive të FSK-së, është objektiv dhe prioritet kyç i imi dhe i komandantëve në të gjitha nivelet. Ushtrimi fushor ,,Shqiponja 3" është finalizim i suksesshëm i ciklit të stërvitjeve individuale dhe kolektive të FSK-së, për këtë vit, dhe tregues i gatishmërisë së lartë operacionale të njësive të FSK-së. Gjeneral Kastrati tha gjithashtu se gjatë këtij viti kemi marrë pjesë edhe në ushtrime të përbashkëta jashtë vendit, si në Slloveni, ku pjesëtarët tanë kanë treguar profesionalizëm disiplinë dhe përkushtim të lartë. Këto ushtrime janë tregues se FSK-ja është e gatshme të kryejë dhe të zbatojë të gjitha detyrat që i jepen nga institucionet qendrore të vendit, qoftë edhe ajo për shndërrimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.





Sipas skenarit të ushtrimit, njësitë e Mbrojtjes Kimike Biologjike Atomike (MKAB), Kërkim Shpëtimit Urban(KSHU), Njësia e Deminimit dhe Eliminimit të Mjeteve të Pashpërthyera (EOD), si dhe Njësia e Mjekësisë ishin paraparë që të intervenojnë në operacion secila për fushën e saj profesionale të veprimit. Fillimisht MKAB ka kryer detektimin dhe pastaj ka kryer edhe dekontaminimin e të lënduarve, personelit dhe pajisjeve, gjithashtu paramedikët e MKAB-së kanë ofruar edhe ndihmën e parë. Për të evakuuar personat dhe sanuar vendin e shpërthimit në vend incident ishin angazhuar edhe ekipet e deminimit dhe ato të EOD-së. Qëllimi i angazhimit të tyre ishte eliminimi i mjeteve eksplozive të pashpërthyera si dhe nxjerrja dhe evakuimi i të lënduarve nga zona e operacionit. Gjithnjë sipas skenarit të ushtrimit në zonë kanë qenë të angazhuar edhe ekipet e kërkim- shpëtimit urban të cilët nga rrënojat e ndërtesës së shembur arritën të evakuojnë personat e lënduar dhe ata që kishin mbetur të ngujuar nga pasojat e shpërthimit. Ndërsa Kompania e Mjekësisë ka ofruar përkujdesje mjekësore për të lënduarit nga pasojat e shpërthimit të realizuar sipas skenarit të paraparë në ushtrim.



Qëllimi i mbajtjes së ushtrimit fushor "Shqiponja 3" ishte testimi i aftësive komanduese, reaguese dhe koordinuese të njësive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren. Në operacionet e ushtrimit "Shqiponja 3" kanë qenë të angazhuar 110 pjesëtarë si dhe 19 automjete.
Për të parë nga afër operacionet përfundimtare të ushtrimit "Shqiponja 3" në zonën e operacionit ishin për vizitë; ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministri, Bejtush Gashi, zëvendëskomandanti njëherësh komandant i KFT-së, gjeneral major Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, z. Shkëlzen Sylaj, të gjithë gjeneralët e FSK-së, atashetë ushtarak të akredituar në Kosovë, përfaqësues të KFOR-it, të NAT-it, NLAT-it si dhe të ftuar të tjerë.

Komandanti i KFT-së përcolli trajnimin "Taktikat me njësi të vogla"

Brigada për Reagim të Shpejtë vazhdon mbajtjen e trajnimit "Taktikat me njësi të vogla", ku i janë bashkuar edhe pjesëtarë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, të Brigadës për Mbështetje Operacionale, (BMO) të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) dhe të Policisë së Forcës (PFSK) .
Për ta përcjellë nga afër trajnim "Taktikat me njësi të vogla" i cili po mbahet në fshatin Zhegoc të Komunës së Gjilanit, ishin: zëvendëskomandanti i FSK-së, dhe komandant i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, atasheu amerikan, majori Meltone dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it.
Zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për angazhimin maksimal gjatë mbajtjes së trajnimit "Taktikat me njësi të vogla", "jemi të vetëdijshëm për vështirësitë nëpër të cilat keni kaluar, kur kemi parasysh nivelin sfidues të këtij trajnimi, megjithatë, kjo është ajo që kërkohet nga ne, përgatitja profesionale, fizike dhe psikike", për të kërkuar nga pjesëtarët e FSK-së, " mësimet e mësuara nga ky trajnim, përcillni tek pjesëtarët e tjerë të FSK-së". Trajnimi i pjesëtarëve të FSK-së, "Taktikat me njësi të vogla" ka filluar të realizohet, më 15 shtator dhe pritet të përfundoi më 17 tetor 2014. Kjo ka qenë gjenerata e tretë për vitin 2014, ndërsa e gjashta me radhë e trajnuarve në ,,Taktikat me njësi të vogla" që organizon dhe realizon BRSH-ja. Gjatë këtij trajnimi pjesëtarët janë pajisur me njohuri të reja, si në teori ashtu dhe në praktikë, në fusha të ndryshme, ndërsa fokusi kryesor gjatë trajnimit ka qenë ngritja dhe profesionalizimi i Forcës së Sigurisë të Kosovës për kryerjen e detyrave dhe realizimin e misionit të tanishëm dhe përgatitjet për të ardhmen.





Kadetët e FSK-së mbajtën ushtrimin fushor "Vjeshta 2014"

Bazuar në planin kalendarik të trajnimeve, njësitet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), janë duke realizuar trajnime të ndryshme. Qendra e Studimeve Universitare (QSU) ka realizuar ushtrimin fushor të koduar me emrin "Vjeshta 2014". Pjesën teorike të trajnimit kadetët e kanë realizuar në hapësirat e kësaj qendre nga instruktorët e KDS-së, ndërsa pjesën praktike e kanë realizuar në ambientet e kazermës "Skënderbeu", prej datës 10 deri më 12 tetor 2014.



Në këtë ushtrimin fushor kanë marrë pjesë stafi udhëheqës i QSU-së, dhe kadetët e katër gjeneratave (41 kadetë) të cilët kanë punuar në grupe për të realizuar ushtrimin. Disa nga temat e realizuara gjatë këtij ushtrimi ishin: ngritja e kampit, okupimi i bazës patrulluese, ndërtimi i pozicioneve luftarake, rikonicioni i zonës, sulmi, prita, patrullimi, pikat e kontrollit, pastrimi i dhomave, kordonkërkimi etj.
Vlerësimi i stafit udhëheqës ishte se ushtrimi fushor "Vjeshta 2014" ka qenë mjaft frytdhënës dhe ka ndihmuar kadetët që të shohin sfidat me të cilat mund të ballafaqohen gjatë karrierës së tyre ushtarake dhe vendimet të cilat duhet t'i marrin.
Komandanti i Qendrës për Studime Universitare (QSU), kapiteni Avni Kiçina ka vlerësuar angazhimin maksimal të kadetëve, të cilët përveç pjesës teorike të cilën janë duke e realizuar në hapësirat e QSU-së, ata po e kompletojnë edhe pjesën praktike që ka qenë shumë e nevojshme për kadetët.
Vlen të ceket se gjatë periudhës katërvjeçare kadetët realizojnë disa ushtrime fushore, mirëpo kadetët e vitit të parë janë ata që kanë nevojë më shumë të familjarizohen me rolin dhe me detyrat që duhet t'i kryejnë në terren dhe me sfidat me të cilat duhet të ballafaqohen.

Certifikohen nënoficerët e kursit "Liderit Luftarak" gjenerata e dytë 2014

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) më 17 tetor 2014, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve të kursit, Lideri Luftarak, gjenerata 02/2014. Ky kurs u realizua nga instruktorë të FSK-së, të trajnuar dhe licencuar nga Akademia e Nënoficerëve të Armatës së 7-të, të Ushtrisë Amerikane në Graefenwehr , në Gjermani, dhe është mbështetet nga instruktorë Amerikanë.
Kursi është adoptuar për nevojat e FSK-së, dhe ka zgjatë katër javë, ndërsa në këtë periudhë janë mbajtur ligjërata me tema të ndryshme, si: Udhëheqja ushtarake, shëndeti dhe fitnesi fizik, trashëgimia e trupave të nënoficerëve, historia ushtarake, ndihma e parë dhe navigimi tokësor. Kursi ka qenë rezident dhe është realizuar në sistem të kombinuar teori dhe praktikë, në të cilin seciili nga kadetët kanë pas rastin të shohin rolin e tyre në situata të ndryshme.
Në ceremoni e certifikimit morën pjesë; komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës për Mbështetje të Operacioneve gjeneral brigade Ilaz Dërguti, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, si dhe oficerë të lartë të FSK-së, të NLAT-it dhe të Ushtrisë Amerikane.
Me këtë rast, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, në fjalën e tij, para të pranishmëve, ndër të tjera, tha: "Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes organizon shumë kurse nga niveli bazik e deri te ato të avancuara, individuale dhe kolektive, mirëpo, kursi i Liderit Luftarak është një nga kurset të cilat përgatit pjesëtarët edhe për karrierë, por edhe për jetën, organizimin, ngritjen e lartë profesionale dhe motivimin. Në anën tjetër, ky kurs ka edhe të veçantat tjera, sepse është i adaptuar nga ushtria amerikane dhe ka pas një bashkëpunim ndërmjet FSK-së dhe ekipit të ushtrisë amerikane, që nga faza e planifikimit e deri te ekzekutimi final i tij, duke ndihmuar dhe këshilluar pjesëtarët e FSK-së."



Gjeneral brigade Enver Cikaqi vizitoi Forcat e Armatosura të Republikës së Maqedonisë

Në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunimit bilateral në mes të Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ditë më parë qëndroi për një vizitë zyrtare në Forcat e Armatosura të Republikës së Maqedonisë.
Delegacioni i FSK-së u prit nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Republikës së Maqedonisë, gjenerali Naser Sejdini, i cili, me këtë rast, e njoftoi gjeneral Cikaqin me zhvillimet dhe të arriturat e Forcave të Armatosura të Maqedonisë dhe bashkëpunimin e deritanishëm si dhe vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen me FSK-në.
Gjeneral Cikaqi gjatë qëndrimit në Maqedoni vizitoi Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (njësinë homologe) në Veles, Qendrën e Mbështetjes së Trajnimeve në Krivollak dhe Pepelistë, Akademinë Ushtarake në Shkup, Qendrën e Trajnimit të Kadetëve në Shkup, si dhe pati një vizitë në Akademinë Ushtarake në Shkup, ku takoi kadetët e FSK-së të cilët studiojnë në këtë Akademi.
Gjatë takimeve që gjeneral Cikaqi pati me udhëheqësit e Forcave të Armatosura të Maqedonisë, kërkoi nga ta avancimin e bashkëpunimit në mes njësive të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcave të Armatosura të Maqedonisë.
Gjithashtu, komandant i KDS-së i Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë, koloneli Ljupcho Kostovski, shprehu nevojën e bashkëpunimit dhe premtoi se ky bashkëpunim do të avancohet edhe më tej.
Të dy komandantët u pajtuan për zgjerimin edhe thëllimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët.
Ekipi i KDS-së vizitoi edhe kadetët e FSK-së të cilët studiojnë në Akademinë Ushtarake në Shkup, ku u njoftua me kushtet dhe mundësitë të cilat ofron kjo Akademi. Vlen të theksohet se FSK-ja ka nënë kadetë të cilët studiojnë në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë, të cilët u shprehën të kënaqur me përvojat që ata janë duke i marrë gjatë studimeve.



Bashkëpunim i mirë në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë



Me ftesë të Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë, një delegacion i Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së, të prirë nga kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim, Florin Hoxha, sekretar permanent i Sekretarit të Përgjithshëm, Sabri Haxholli zyrtar i Departamentit të Personelit dhe atasheu ushtarak në Gjermani, kolonel Xhavit Sadrijaj qëndruan për një vizitë pune në Berlin, ku u pritën nga udhëheqës të Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë. Delegacioni i MFSK-së, gjatë këtij takimi, bisedoi me homologët e tyre gjerman, për bashkëpunimin e gjertanishëm si dhe vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Njëherit gjatë kësaj vizite biseduan për fushat e bashkëpunimit për vitin 2015, duke përfshi fushën e trajnimeve, edukimin si dhe takimet e përbashkëta për shkëmbim të eksperiencave në fusha të ndryshme. Gjithashtu të dy delegacionet punuan në hartimin e planit bilateral për vitin 2015. Gjermania është njeri nga shtetet që po luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e MFSK dhe FSK-së.

Shefi i NLAT-it, gjenerali Peter Braunstein, vizitoi BRSH-në Istog

Dje për një vizitë zyrtare, në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Istog, qëndroi shefi i NLAT-it, gjeneral brigade Peter Braunstein.



Gjeneralin Braunstein e priti komandanti i BRSH-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj me bashkëpunëtorë. Gjeneral Brahimaj e njoftoi shefin e NLAT-it me misionin e Brigadës për Reagim të Shpejtë, për aktivitetet, trajnimet, të arriturat dhe për sfidat e BRSH-së.

Gjatë takimit ata diskutuan edhe për fushën e bashkëpunimit në mes BRSH-së dhe NLAT-it, bashkëpunim ky i cili është duke ndikuar në ngritjen dhe zhvillimin profesional të BRSH-së, u tha gjatë bisedës.

Gjenerali Braunstein përcolli nga afër edhe ushtrimin e Batalionit të 3 për Reagim të Shpejtë dhe trajnimin Taktikat me Njësi të Vogla. Ai shoqërohej nga oficeri i NLAT-it; koloneli Rafet Kiliç dhe këshilltarët e NLAT-it, për BRSH-në,.kolonel Henrik Krogh dhe nënkolonel Alexander Noel.

Kjo ishte vizita e parë e gjeneralit Braunstein, që nga koha kur është emëruar shef i NLAT-it.

Rruga në fshatin Bllagagjë, vepër e FSK-së





Në fshatin Bllagagjë të Komunës së Istogut, u bë përurimi i rrugës dy kilometra të gjatë dhe me kanale anësore kulluese i ndërtuar nga Batalioni i Xhenios i FSK-së, në kuadër të zhvillimit të projekteve dhe bashkëpunimit civil-ushtarak, projekte këto të kryera nga FSK-ja, e që janë në shërbim të komunitetit anembanë Kosovës. Në përurimin e kësaj vepre që lidh fshatrat me qendrat urbane, përveç vlerës praktike ka edhe atë simbolike, të ndihmës dhe bashkëpunimit.

Në ceremoninë e përurimit ishin: ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Nenad Rashiq, zëvendësministrja e FSK-së, Jasmina Vasiq, kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, komandanti i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Ilaz Dërguti, oficerë të FSK-së dhe përfaqësues të komunitetit serb.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, falënderoi pjesëtarët e Batalionit të Xhenios për punën e madhe që kanë bërë dhe po bëjnë kudo në Kosovë, për të shtuar se FSK-ja, deri më tani ka kryer shumë projekte humanitare që janë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe në shërbim të komuniteteve. Gjeneral Kastrati premtoi se edhe në të ardhmen do të vazhdojnë me realizimin e projekteve të këtilla, kudo që kanë nevojë qytetarët e Kosovës.

Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, tha se ky projekt është i një rëndësie të veçantë, sepse përmes tij synojmë integrimin e komuniteteve në jetën tonë të përditshme.

Ndërsa, Nenad Rashiq, ministër për Punë dhe Mirëqenie Sociale, falënderoi FSK-në për realizimin e këtij projekti, për të shtuar se realizimi i këtyre projekteve është i një rëndësie të veçantë jo vetëm për komunitetet por edhe për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Projekti për rrafshimin, zgjerimin dhe hapjen e kanaleve anësore, ka filluar së realizuar më 16 shtator 2014 dhe ka përfunduar më 3 tetor 2014. Shtrimi i kësaj rruge është bërë në bashkëpunim më Zyrën për Komunitete të Komunës së Istogut, duke u bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe kësaj komune.

Për punët e realizuara gjatë rregullimit të rrugës në fshatin Bllagagjë, foli shefi i Shtabit të Batalionit të Xhenios, major Ilmi Ramusholli.

Shiritin e përurimit e prenë: komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kryetari i Komunës së Istogut Haki Rugova dhe përfaqësuesi i fshatit Bllagagjë.

□atalioni i □henios në shër□i□ të □ltetarëve të Kosovës

Batalioni i Xhenios i Brigadës për Mbështetje Operacionale të Forcës së Sigurisë, përfundoi me sukses shumë projekte në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Për të mësuar më shumë lidhur me aktivitetet e këtij batalioni biseduam me shefin e Shtabit të Xhenios, major Ilmi Ramusholli, i cili ndër të tjera theksoi se ky batalion ka kryer qindra projekte si: rrugë, ura, kanale, rrafshim dhe nivelim të oborreve të shkollave, ndërtim të shtëpive, meremetim të shkollave, çerdheve etj". Majori Ramusholli po ashtu numëroi edhe disa projektet vërtetë kapitale të përfunduara, po, nga ky batalion siç janë: ura në fshatin Rakovinë, ura në fshatin Zllakuqan, pastaj projekti i rrugëve në Komunën e Artanës, fshati Zebincë, projekti në Dragodan të Prishtinës, rruga në fshatin Vërbovc të Drenasit, ngritja e dy urave në Manastirin e Deçanit, dhe tani së fundi rruga në fshatin Bllagagjë të Komunës së Istogut. Po ashtu, Batalioni i Xhenios është duke realizuar ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Buzhevac-Ranillukë, me gjatësi 3.8 kilometra, ku deri më tani ka përfunduar hapja e kanaleve, nivelimi i rrugës dhe shtrirja e zhavorrit. Ky projekt pritet të përfundojë, së shpejti, para afatit të paraparë. Nga këto projekte kanë përfituar banorët e këtyre fshatrave, kryesisht ata të komunitetit serb.

Certifikohen deminerët e FSK-së, niveli i 3-të

Komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civle, koloneli Shaip Haziri me rastin e diplomimit -certifikimit të deminerëve, tha:"Është kënaqësi që jam pjesë e finalizimit të këtij trajnimi, e sidomos pjesë e kësaj njësie nga e cila vazhdimisht po krijohen kuadro të specializuara dhe të profesionalizuara, të cilat po kontribuojnë në sigurinë e jetës së popullit të Kosovës.





Koloneli amerikan Evan Trinkle, me këtë rast tha: "Të 14 anëtarët e FSK-së, që morën pjesë në këtë kurs për pesë javë, janë njerëz të guximshëm dhe qytetare të të njëjtit mendim që dëshirojnë një ambient të sigurt për të gjithë popullin e Kosovës. EOD kanë bërë një punë kërkuese, por të dobishme në Kosovë. Në nëntë muajt e fundit, ka asgjësuar mbi 50 mjete të pashpërthyera në mënyrë të sigurt dhe 40 operacione të përbashkëta të shkatërrimit me ekipin e FSK-së, dhe 10 përgjigjet ndaj raportimeve për mjete të pashpërthyera në pjesën veriore të Kosovës, në veri të lumit Ibër. Unë e di se anëtarët e FSK-së, që janë sot këtu, do të kryejnë misionin e tyre pa asnjë të metë. Unë e di që ju do të kryejë misionin tuaj me integritet dhe profesionalizëm të standardeve më të larta" tha në fund koloneli amerikan Trinkle.

Kurse komandanti i Kompanisë së Deminimit, kapiten Sejdi Krasniqi, tha: "Kursi specialistik EOD 3, është mbajtur nga instruktorët e Kompanisë së Deminimit dhe është monitoruar nga instruktorët e KDS-QSS-së dhe instruktorët e specializuar të EOD-së, të KFOR-it amerikan.

Kursi i Eliminimit të Mjeteve të Pashpërthyera (EOD) ka filluar më 08 shtator 2014 dhe ka përfunduar më 09 tetor 2014. Në fund, gjeneral Cikaqi, koloneli Trinkle, gjeneral Dërguti dhe kolonel Haziri, për të gjithë të diplomuarit ndanë certifikata.

Intervistë me komandanten e EOD të KFOR-it amerikan

Deminerët e FSK-së janë të përgatitur të shkatërrojnë mjete më të mëdha se 9 tonë



Gazeta "Forca Jonë": *Cili ka qenë niveli i trajnimit të EOD-së?*

Jonill Castillo, 1LT US EOD Comander: Ky ishte niveli i tretë i trajnimit të pjesëtarëve të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, i cili u mbajt ditë më parë nga FSK-ja. Ishte një trajnim shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të gjithë deminerët-teknikët e EOD-së, të cilët do të aftësohen për çminimin e mjeteve të pashpërthyera. Kjo do të ndikoj në ngritjen e nivelit të sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës, KFOR-in. Me kryerjen e këtij niveli, të gjithë teknikët pjesëmarrës në këtë trajnim janë aftësuar që në mënyrë të pavarur të bëjnë shkatërrimin e mjeteve më të mëdha se 9 tonë.

Gazeta "Forca Jonë": *Pas trajnimi, sa janë aftësuar deminerët e FSK-së për shkatërrimin e mjeteve të pashpërthyera të këtij niveli?*

Jonill Castillo, 1LT US EOD Comander: Ishte një trajnimi i planifikuar mirë dhe i realizuar brenda pesë javësh, të cilin ekipi i EOD -së e ka kryer me sukses me ekipin e deminërve të FSK-së, të cilët janë përgatitur profesionalisht për atë që duhet ta bëjë një forcë e EOD-së. Mendoj se ata janë të zotët të kryejnë çfarëdo lloj veprimi për shkatërrimin e mjeteve të pa shpërthyera. Ata janë treguar jashtëzakonisht të suksesshëm në zbulimin e mjeteve të pashpërthyera dhe në pastrimin e zonave të minuara në Kosovë. Besoj se në të ardhmen e afërt ata do të përmbushin një nga standardet e NATO-s, duke bërë trajnime shtesë dhe se janë në rrugë të mirë, në këtë drejtim.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është mesazhi Juaj?*

Jonill Castillo, 1LT US EOD Comander: Komentet të cilat i kam marrë nga ushtarët e mi, tregojnë se deminerët e FSK-së janë të zotët, kanë përparuar dhe janë trajnuar mirë, edhe pse koha e trajnimit ka qenë e shkurtër. Nëse komandanti i EOD-së, kërkon trajnime shtesë nga ushtria amerikane, atëherë, ne, jemi të gatshëm ta bëjmë këtë. Do të ishte një ide e mirë të vazhdohet me trajnime.

Deminerët: "Të gatshëm të kryejmë çdo detyrë të EOD-së "



Instruktori Sadush Berisha: Trajnimi i nivelit të tretë është ndjekur nga 13 pjesëtarë të Kompanisë së Deminimit duke përfshirë gradat e togerit, nënoficerit dhe ushtarit. Ky trajnim ka filluar më 8 shtator dhe ka përfunduar më 9 tetor 2014. Sipas shefit të instruktorëve, Sadush Berisha, ky trajnim më herët i ka kushtuar financiarisht FSK-së ngase është mbajt nga organizatat civile, kurse për herë të parë është duke u mbajtur nga instruktorët e FSK-së. Trajnimi ka qenë i nivelit të lartë dhe këtu kanë ndikuar shumë faktorë duke përfshirë bashkëpunimin e mirë mes EOD-së dhe KFOR-it amerikan, si dhe bashkëpunimin me instruktorët e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Ky trajnim specialistik ka përfshirë mjetet dhe raketat e dirigjuara deri në 9 ton dhe mjete tjera të rrezikshme. Rreshteri Berisha thotë që kanë plane edhe për trajnime tjera specialistike, të cilat duhet të realizohen me cikle pasi që janë të një rëndësie të veçantë dhe kanë të bëjnë me një rrezikshmëri të lartë. Ai lidhur me rezultatet e këtij trajnimi ndër të tjera thotë: "Pjesëtarët e deminimit të FSK-së kanë treguar disiplinë të lartë, siguri maksimale gjatë çminimit të mjeteve të pashpërthyera dhe rezultate të pritshmërisë teorike dhe praktike. Të gjitha këto janë monitoruar nga KFOR-i amerikan dhe nga instruktori i KDS-se, në Ferizaj, ku edhe presim një raport prej tyre për punën tone, dhe duke u bazuar nga ato që i thash, raporti do jetë pozitiv", thotë Rreshter Sadush Berisha, shef i instruktorëve të EOD niveli i katër.



Pjesë e këtij trajnimi ishte edhe kapter Ramadan Berisha, në rolin e monitoruesit nga KDS, i cili duke u bazuar në rezultatet e arritura gjatë pesë javëve sa ka zgjatur trajnimi u shpreh: "Detyra jonë si monitorues ka qenë kontrolli dhe zbatimi i planit të trajnimit, gjë që është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme. Plani i hartuar është zhvilluar me përpikëri dhe niveli i instruktorëve të FSK-së, (deminimit) ka qenë shumë i mirë. Instruktorët e FSK-së janë të gatshëm të zhvillojnë trajnime të nivelit profesional edhe pa mbikëqyrjen e monitoruesve të KFOR-it. Këtë e vërteton edhe suksesi i tyre, ku ndër ta ka pasur arritje të rezultateve 100%, ndërsa niveli mesatar ka kaluar 90%" përfundon instruktori i KDS-së Berisha.



Ushtar Roland Reshitaj, ndjekës i kursit thotë: "Intensiteti i trajnimit ka qenë i lartë, saqë, neve na ka mbajtur tërë kohen të angazhuar dhe kjo ka ndikuar në arritjen e rezultateve të kënaqshme grupore. Në përqindjen e lartë të rezultateve ka ndikuar edhe raporti profesional në mes instruktorëve dhe kursantëve, duke pas parasysh që niveli EOD 3 është trajnim specialistik. Gjithashtu raporti i jashtëzakonshëm ka qenë edhe me instruktorët amerikan dhe gjatë kësaj periudhe ne kemi pasur mundësi t'i shkëmbejmë përvojat në fushën e deminimit".



Të suksesshëm dhe të nevojshëm këtë trajnim e quan edhe Rreshter Blerim Bajraktari, kadet i kursit. "Edhe pse kam përvojë prej TMK-së (14 vite), në nivelin EOD 2, tashmë kemi kryer një nivel edhe më të lartë, atë të EOD 3, i cili më ka ndihmuar në zgjerimin e njohurive specialistike për armët e dirigjuara dhe bombat që lidhen nga ajri. Pas përfundimit të këtij kursi, jam i gatshëm të kryej çdo detyrë të EOD-së edhe të nivelit specialistik, kurdo që kërkohet nga unë nga zinxhiri im komandues".

Ministri dhe Komandanti i FSK-së i ndanë Mirënjohje nënkolonelit Jakobsson



Në ambientet e Ministrisë për FSK-në, sot ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati pritën oficerët ndërlidhës të Ushtrisë së Suedisë në Kosovë, nënkolonelët Kurt Jakobsson dhe Johan Falkholt. Me këtë rast, ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati e falënderuan oficerin Kurt Jakobsson për punën, angazhimin dhe bashkëpunimin e deritashëm në mes të FSK-së dhe Ushtrisë suedeze, ndërsa, nënkolonelit Johan Falkholt i dëshiruan mirëseardhje dhe vazhdim të suksesshëm të punës së paraardhësit të tij. Ministri dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati i ndanë Mirënjohje nënkolonelit Jacobsson në shenjë respekti për kontributin e tij në bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Ushtrisë së Suedisë dhe FSK-së, për angazhimin e Ushtrisë suedeze në pastrimin e Parkut të Gërmisë si dhe për mbështetjen e tyre të pakursyer në fushën e kërkim-shpëtimit.

Takim miqësor në futboll midis ekipit përfaqësues të FA të Shqipërisë dhe përfaqësueses së FSK-së







Në kuadër të bashkëpunimit në mes FA të Republikës së Shqipërisë dhe FSK-së, më 13 tetor 2014, në stadiumin "Qemajl Stafa" në Tiranë, u zhvillua takimi miqësor në futboll të madh në mes të ekipeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe atij të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Në këtë takim morën pjesë: ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneral brigade Enver Cikaqi, ambasadori dhe atasheu i Republikës së Kosovës në Shqipëri, z. Ramiz Lladrovci dhe nënkolonel Enver Dugolli, si dhe ushtarakë dhe oficerë të FA të Shqipërisë dhe përfaqësues të Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe mjaft sportdashës të kryeqytetit.

Ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, përshëndeti dy ekipet pjesëmarrëse si dhe të gjithë të pranishmit e tjerë që kishin mbushur shkallët e stadiumit "Qemal Stafa" për të ndjekur këtë ndeshje miqësore. Në mënyrë të veçantë ministrja Kodheli falënderoi ekipin e futbollit të FSK-së, për pranië e tyre siç e quajti ajo" në këtë takim vëllazëror"duke ju uruar suksese të dyja ekipeve dhe duke nënvizuar që të fitojë më i miri.

Edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati përshëndeti ekipet pjesëmarrëse dhe të pranishmit e tjerë, në këtë takim sportiv, duke shprehur, njëherësh, edhe mirënjohjen e tij të thellë për bujarinë dhe miqësinë shqiptare. Gjeneral Kastrati në fund, falënderoi Ministrinë dhe FA të Shqipërisë për kontributin e tyre të dhënë për FSK-në.

Gjatë takimit, krahas demonstrimit të aftësive të mira tekniko-sportive dhe shpirtit të lartë luftarak, spikati dukshëm edhe fryma e ngrohtë vëllazërore midis dy ekipeve përfaqësuese të dy vendeve dhe ushtrive tona.

Takimi miqësor përfundoi me rezultatin 1:1, dhe pas ekzekutimit të penalltive fitorja i takoi ekipit përfaqësues të FA të Shqipërisë, 6:5

Në fund shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe komandanti i FSK, gjenerallejtënant Kadri Kastrati i dorëzuan kupën ekipit fitues.


Toger i FSK-së, Getoar Rexhepi shpallet kampion i karatesë për Senior në Republikën e Shqipërisë



Getoar Rexhepi oficer i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK-së) më 25 tetor 2014, ka marrë pjesë në Kampionatin e 21-të Kombëtar në Karate, të organizuar nga Federata Shqiptare e Karatesë në Tiranë. Toger Rexhepi, gjatë garave tregoi shkathtësi dhe profesionalizëm të lartë. Ai, në kategorinë Senior, zuri vendin e parë, dhe shpallet Kampion i Republikës së Shqipërisë.

Getoar Rexhepi është sportist i dalluar i cili ka fituar dhjetë herë radhazi titullin e Kampionit të Kosovës në Karate, në kategori të moshave të ndryshme. Gjithashtu edhe këtë vit, (25.09.2014) në kampionatin e karatesë në Kosovës, për senior zuri vendin e dytë, organizuar nga Federata e Karatesë së Kosovës, në Prishtinë. Getoar Rexhepi ka kryer studimet në Qendrën e Studimeve Universitare (QSU) të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) dhe tani shërben në Batalionin e Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, në Istog. Getoari ka dhjetë vjet që është në majat e karatesë në Kosovë dhe Shqipëri. Toger Rexhepi si pjesëtarë i FSK-së, dallohet për sjellje shembullore, për disiplinë, punë profesionale dhe angazhim maksimal në jetësimin e detyrave të përgjithshme të Batalionit të Tretë të BRSH-së dhe në përgjithësi të FSK-së.

FSK-ja merr pjesë në marshim mbi 25 kilometra organizuar nga KFOR-i Danez



Kontingjenti danez që vepron në kuadër të KFOR-it, në Kampin e KFOR-it, në Novosellë, ka organizuar një marshim mbi 25 kilometra të gjatë, ku kanë marrë pjesë qindar pjesëtarë të shumë përfaqësuesve të ushtrive që veprojnë në kuadër ë KFOR-it, në Kosovë.

Në këtë marshim, së bashku me pjesëtarë të KFOR-it, morën pjesë edhe 33 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nga njësitet e ndryshme të saj.

Marshimi i organizuar nga KFOR-it, danez, tani më, është bërë tradicional, që nga viti 1972, me rastin e stacionimit të ushtareve danez, në Qipro, ndërsa në fundin e viteve të 90-ta, kontingjenti danez filloj t'i ftoj edhe përfaqësuesit e organizatave ushtarake ndërkombëtare të cilat vepronin në zona veprimi.

Në finalizimin e marshimit, tre pjesëtarë të FSK-së, u renditën në dhjetëshen e parë të marshuesve më të mirë.



www.mksf-rks.org

FORCA JONË

Të gatshëm për detyra të reja!

Viti i III• Nr.30 •Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

DITA E FORCËS

Të gatshëm për detyra të reja!



Prishtinë, nëntor 2014



FORCA JONË

Të gatshëm për detyra të reja!

Viti i III• Nr.30 •Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti i III• Nr. 30• Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun,
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Adresa: MFSK, Kazerma „Adem Jashari", Prishtinë

Adresa elektronike: informimi.mfsk@gmail.com, informimi.mfsk@rks-gov.net

Tel: 038/551-379

www.mksf-ks.org

Përmbajtja:

Të gatshëm për mision të ri ……4
FSK e gatshme për detyra të reja 5
Ministri i FSK-së Agim Çeku uroi komandantin e ri të KFOR-it gjeneralmajorin Francesko Paolo Figliuolo 6
Komandanti i FSK-së u prit me nderime të larta në Suedi 6
Presidentja e Kosovës dhe Komandanti i FSK-së në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së …….....……7
Kryeministri Hashim Thaçi shpalosi idenë e krijimit të forcave të Armatosura……...……7
Ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë në MFSK.....8
Ministria për FSK dhe Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë me protokolle bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes.....8
FSK-ja shënoi 16 vjetorin e "Epopesë së UÇK-së".....9
FSK bënë homazhe në Prekaz …….....……10
FSK-ja parakalon në Ditën e Pavarësisë së Kosovës.....11
Ministri i FSK-së Agim Çeku në Konferencën "Karta e Adriatikut" në Mal të Zi…….....……12
Ministri i FSK-së pjesëmarrës në Konferencën e 50-të të Sigurisë në Gjermani …….....……12
Gjenerallejtënant Kadri Kastrati në konferencën e 22-të vjetore të ushtrive evropiane, në Wiesbaden të Gjermanisë.....……12
Konferencë ndërkombëtare "Mbrojtja e mençur, ndarje, bashkim dhe iniciativë"…….....13
Ministri dhe Komandanti i FSK-së pritën ndihmës Sekretaren e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës Dr. Evelyn Farkas……13
Zëvendëskomandanti suprem i Aleancës së NATO-s për Evropë vizitoi MFSK-në……......……14
MFSK dhe Forcat e Armatosura të Turqisë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë…….....……14
Drejtori për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë Steve Mc Carthy vizitë në MFSK.....15
Konferenca e përbashkët e bashkëpunimit "FSK dhe Partnerët.....15
Komandanti i Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneral Akar në FSK 16
Kundëradmirali suedez Odd Werin vizitoi MFSK-në…….....……16
Gjeneralë të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë në Ministrinë e FSK-së…….....……16
Komandanti i Komandës së Forcave të Bashkuara të Aleancës në Napoli admirali Bruce Clingan në MFSK.....……17
Komandanti i FSK-së priti një delegacion amerikanë të EUCOM-it……...……17
Ministri dhe Komandanti i FSK-së e dekoruan me medalje Komandantin e Gardës Kombëtare të AJOVES…….....……18
Gjenerali Martin Dempsey i uron gjeneral Kastratit Ditën e Pavarësisë……...……18
Ambasadori i SHBA-ve në NATO, Douglas Edward Lute në FSK……...……18
Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën admiralin e NATO-s Bruce Clingan……...……19
Gjeneral Kastrati dhe gjenerali amerikan Timothy Orr përcjellin demonstrimin e njësisë së kërkim-shpëtimi…….....19
Marrëveshje bashkëpunimi në mes Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve dhe MFSK-së …….....……20
FSK në Konferencën e Historisë Ushtarake në Gjermani……...……20
Atasheu amerikan i Mbrojtjes nderohet me medalje…….....……21
Komandantin i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati u prit me nderime ushtarake në Tiranë …….....……21
Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes u certifikuan kadetët nga SHBA dhe FSK-ja……...……22
FSK në ushtrimin e përbashkët "Përgjigjja e menjëhershme 2014" në Slloveni……...……22
FSK testoi kapacitetet operacionale të njësive në terren.....23
Ushtari më i mirë i FSK-së - tetar Binak Podrimçaku 23
Intervenimi i suksesshëm i FSK-së në Termocentralin "Kosova A".....24
Pjesëtarët e MKABK-së trajnohen me sukses në Bullgari…….....25
Diplomoi gjenerata e gjashtë e kadetëve të FSK-së …….....……25
MFSK-së dhe Ministria e Mbrojtjes së Maqedonisë memorandum për shkëmbimin e ekspertëve …….....……26
Kadetët e FSK-së pjesë e "Kampit Veror 2014"në Krivollak të Maqedonisë……...……26
Pjesëtarët e FSK-së trajnohen për Operacione Paqësore.....26
Kadetë e FSK-së trajnohen për Kërkim-Shpëtim në dimër…….....27
Kadetët e FSK-së në ushtrimin fushor "Vjeshta 2014"……...……27
Betimi i kadetëve të rinj të FSK-së ……...……27
Kompania e deminimit gjatë vitit 2014, shkatërroi mbi 1000 mjete të pashpërthyera …….....……28
Certifikohen deminerët e FSK-së, niveli 3-të.....28
Pjesëtarët e FSK-së dhuruan gjak për qytetarët e Kosovës.....29
FSK-ja ngriti urën mobile në fshatin Krushevë të Klinës…….....29
Rruga në fshatin Bllagagjë, vepër e FSK-së……...……29
FSK-ja ndërtoi rrugën në fshatin Zebincë të Artanës…….....30
FSK-ja angazhohet në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën".....30
FSK-ja shënon Ditën Ndërkombëtare të Tokës…….....30
"8 Marsi shënohet në MFSK dhe FSK"……...……31
Certifikohen kadetë në Kursin e Avancuar për Lider Luftarak……...……31
Femrat përfaqësuese të institucioneve të sigurisë pjesë e një tryeze pune në MFSK……...……32
Seminari me temë "Përparimi i integrimit të komuniteteve në FSK".....32
Ndeshje futbolli në mes ekipit përfaqësues të FA të Shqipërisë dhe përfaqësueses së FSK.....33
Kolzh të fotografive 34

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati

FSK e gatshme për detyra të reja



Forca e Sigurisë së Kosovës po e feston përvjetorin e saj të gjashtë. Kjo ditë, tashmë tradicionale, na bashkon të gjithëve për të festuar dhe reflektuar njëkohësisht.

Forca jonë, në themelet e saj ka të skalitur lavdinë dhe përvojën e trashëguar brez pas brezi. FSK-ja si forcë profesionale, shumetnike dhe e motivuar, është institucioni më i besueshëm i vendit. Ky fakt na gëzon e na bën krenarë, e njëkohësisht na obligon edhe më tepër, për të punuar fortë në ruajtjen e imazhit dhe besueshmërisë. Sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat kemi kaluar dhe ato që na presin, janë sprova që do të kalohen falë vullnetit dhe përkushtimit tonë të fortë.

Forca jonë përbëhet nga pjesëtarë të motivuar, të përkushtuar e të brumosur me virtytet më të larta. Përkushtimi, gatishmëria, guximi, profesionalizmi, virtytet dhe vlerat më sublime të mishëruara tek pjesëtarët tonë, na bëjnë t'u gëzohemi arritjeve të deritanishme, dhe na japin fuqi e besim për t'i kaluar edhe sfidat e së ardhmes.

Kjo ditë e veçantë është një moment shumë i përshtatshëm për të shprehur mirënjohjen më të sinqertë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, të cilët po bartin në supet e tyre peshën e ngritjes dhe zhvillimit të FSK-së, në një Forcë moderne dhe profesionale. Pjesëtarët e FSK-së, gjithmonë, janë të gatshëm për të kryer detyrat, nënoficerët e përgatitur dhe të motivuar për të qenë gjithnjë krahë për krahë me ushtarët dhe oficerët që udhëheqin me shembullin personal, janë boshti dhe imazhi i Forcës tonë me të cilën të gjithë krenohemi sot.

Arritjet e FSK-së janë të prekshme, kualitative dhe gjithsesi të pritura. FSK-ja gjatë gjithë këtyre viteve ka ngritur kapacitete operacionale për realizimin e misionit të saj në bazë të mandatit kushtetues. Ka ngritur standarde të realizimit të detyrave, duke shfaqur gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së detyrave. FSK-ja vazhdon të kryejë operacione dhe intervenime të rëndësisë qenësore për qytetarët e vendit, siç janë: Operacionet e deminimit; Operacionet e kërkim-shpëtimit në ujëra, male dhe zona urbane; Reagimi i shpejtë i bashkërenduar me institucionet tjera në rast të krizave; Angazhimi në shumë projekte humanitare në përkrahje të qytetarëve, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, si dhe komuniteteve anë e kënd Kosovës; Asistenca mjekësore në përkrahje të banorëve nga radhët e komuniteteve, nëpër zonat e thella.

FSK-ja është në proces të vazhdueshëm të ndërtimit të kapaciteteve, duke e themeluar Task Forcën e Kërkim- Shpëtimit dhe duke i plotësuar kriteret e vendosura për t'u certifikuar nga Grupi Këshillues i Kërkim-Shpëtimit Ndërkombëtar, gjë që shënon bashkëpunimin e suksesshëm në mes nesh dhe partnerëve tanë.

Këtë vit, FSK-ja, ka marrë pjesë në një varg ushtrime fushore dhe kurse trajnuese, të cilat synojnë thëllimin e bashkëpunimit në mes shteteve të rajonit gjatë reagimit në kriza dhe situata të menaxhimit të krizave. Pjesëtarët e FSK-së kanë dëshmuar që FSK-ja është forcë për të mirë dhe e aftë, gjithmonë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe e gatshme të kontribuojë në sigurinë rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Në zhvillimin tonë të mëtutjeshëm, ne bashkëpunojmë ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë të cilëve ju jemi mirënjohës për mbështetjen e tyre, këshillat dhe ekspertizën. Ne e falënderojmë NATO-n për mbështetjen e vazhdueshme përmes NLAT-it dhe NAT-it.

Ndihemi të bekuar dhe krenarë për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe partneritetin me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Si komandat i FSK-së, me siguri të plotë, ritheksoj që FSK-ja është e gatshme të transformohet në Forcat e Armatosura të Kosovës dhe të merr DETYRAT E REJA - mbrojtjen e vendit dhe qytetarëve të saj. Kjo është një detyrë shumë fisnike dhe jemi plotësisht të përkushtuar ndaj saj.

Në këtë ditë të rëndësishme dua që solemnisht të ua uroj Ditën e Forcës, të gjithë efektivave të FSK-së, të gjithë ushtarëve aktiv dhe rezervë, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së.

Ministri i FSK-së Agim Çeku uroi komandantin e ri të KFOR-it gjeneralmajorin Francesko Paolo Figliuolo



Ministri i FSK-së, Agim Çeku, priti në ambientet e reja të Ministrisë së FSK-së, komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Francesko Paolo Figliuolo, me që rast, edhe njëherë i uroi detyrën e re të komandantit të KFOR-it.

Kjo është vizita e parë e komandantit të KFOR-it, gjeneralit Francesko Paolo Figliuolo, në Ministrinë e FSK-së, prej se ka marrë detyrën e re të komandantit. Ministri Çeku, me këtë rast, e njoftoi komandantin e KFOR-it, me të arriturat e përgjithshme dhe perspektivën e FSK-së. Me gjithë se takimi i ministrit dhe komandantit të ri të KFOR-it kishte me tepër karakter njohës, ata qe të dy ri- konfirmuan vazhdimin e bashkëpunimit dhe partneritetit në mes të FSK-së dhe KFOR-it edhe në të ardhmen.

Komandanti i FSK-së u prit me nderime të larta në Suedi

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i ftuar nga komandanti i Forcave të Armatosura të Suedisë, gjenerallejtënant Jan Salestrand, nga 19 deri 22 maj 2014 ka qëndruar në vizitë zyrtare në Suedi.

Qëllimi i kësaj vizite ishte zhvillimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit në mes Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Suedisë.

Në fokus të takimeve ishte përkrahja e Forcave të Armatosura të Suedisë, sidomos në ngritjen e Njësisë Rajonale të Kërkim-Shpëtimit dhe Qendrës së Ekselencës, duke përkrahur trajnimin e instruktorëve, mbështetjen me pajisje dhe përkrahjen për trajnimin dhe certifikimin e stafit të Njësisë rajonale të Kërkim-Shpëtimit nga INSARAG.





Presidentja e Kosovës dhe Komandanti i FSK-së në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së

Presidentja e Republikës së Kosovës, z. Atifete Jahjaga, së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në maj 2014, vizituan kadetët e Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së. Presidentja Jahjaga i përgëzoi kadetët për përkushtimin e tyre në ngritjen e këtij institucioni qenësor për të ardhmen e Republikës së Kosovës. "Ju e dini mirë, se për çdo institucion që është krijuar në Kosovën e pasluftës, se sa sfidues është çdo fillim. I tillë ishte edhe rrugëtimi i qytetarëve tanë për të realizuar ëndrrën e gjeneratave të tëra, për të ndërtuar një Kosovë që frymon lirshëm, një shtet të lirë, shtet të pavarur dhe sovran. Ju kadetë do të jeni jo vetëm përfituesit e trajnimeve dhe shkollimit profesional me standarde të NATO-s, por edhe shtylla e Forcës tonë të Armatosur. Jam shumë krenare për arritjet tuaja dhe me padurim pres ditën kur ju do ta integroni Kosovën në Aleancën Veri Atlantikë".

Kryeministri Hashim Thaçi shpalosi idenë e krijimit të Forcave të Armatosura

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë vizitës së tij në kazermën Adem Jashari, para stafit të lartë të FSK-së, shpalosi idenë e krijimit të Forcave të Armatosura, me ç'rast u shpreh: "Themelimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës janë segmente përmbyllëse të institucioneve që rrumbullakojnë shtetësinë e Kosovës. FSK-ja është një ngjarje e suksesshme e ndërtimit dhe ngritjes së një strukture të rëndësishme të Republikës së Kosovës. Forca e Sigurisë së Kosovës mund të krenohet me shumë arritje të realizuara brenda mandatit të saj të tanishëm. Tani është koha kur ne duhet të marrim përgjegjësinë e plotë për sigurinë e shtetit tonë, e kjo do të nënkuptojë ndryshime të rëndësishme në mandatin, misionin, madhësinë dhe strukturën e saj. Pra Forcat e Armatosura të Kosovës do të zhvillohen ashtu që të jenë të gatshme dhe të afta ta mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, t'i mbrojnë interesat e Kosovës, qytetarët e saj dhe pronën e tyre, do të kontribuojnë për ndërtimin dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe atij global. Në rrugëtimin tonë të mëtutjeshëm drejt zhvillimit të forcës së re mbrojtëse, ne do të vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë".





Ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë në MFSK

Në ambientet e MFSK-së qëndroi për një vizitë zyrtare ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë znj. Mimi Kodheli, e cila u prit me nderime të larta nga Togu i Nderit dhe Orkestra Frymore e FSK-së. Në takim me ministren Kodheli përveç ministrit Çeku ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët Zymer Halimi, Bashkim Jashari, Gëzim Hazrolli dhe Enver Cikaqi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, nënkolonel Hasan Hoxha- ushtrues i detyrës së drejtorit në Departamentin për Siguri dhe Bashkëpunim. Ndërsa pjesë e delegacionit të ministres Kodheli ishin edhe Islam Lauka- ambasador i Shqipërisë në Kosovë, Gjergj Teneqexhiu -drejtor i kabinetit, Edlira Prendi- këshilltare për shtyp, Arian Zaimi- këshilltar ushtarak dhe kolonel Fiqri Hoxha- atashe ushtarak. Ky ishte takimi i parë i ministres Kodheli në Kosovë. Ministri Çeku dhe ministrja Kodheli, gjatë takimit të tyre, ndanë të njëjtin mendim për ngritjen dhe thellimin e bashkëpunimit në mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Ministria për FSK dhe Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë me protokolle bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, Muhamet Latifi dhe zëvendësministri i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Dritan Hila, nënshkruan protokollet "Mbi Bashkëpunimin dhe Asistencën në Fushën e Integrimit Euro-Atlantik dhe Rajonal", si dhe "Mbi Bashkëpunimin në Fushën e Arsimimit dhe Trajnimit Ushtarak" ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i këtyre protokolleve është bashkëpunimi, koordinimi i përbashkët dhe asistenca për MFSK-në në procesin e anëtarësimit në strukturat e sigurisë kolektive të NATO-s dhe iniciativat rajonale, si dhe vendosja e bashkëpunimit në fushën e arsimimit dhe trajnimit ushtarak ndërmjet dy vendeve.





FSK-ja shënoi 16 vjetorin e "Epopesë së UÇK-së"

Me rastin e 16-vjetorit të rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari, nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, më 5 Mars 2014, në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt manifestimi qendror "Epopeja e UÇK-së" në të cilën morën pjesë: Presidentja e Republikës Atifete Jahjaga, kryetari i Parlamentit të Kosovës Jakup Krasniqi, kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ambasadorë të akreditуar në Kosovë, përfaqësuesi i familjes Jashari, Bekim Jashari, ministra, deputetë, drejtues të institucioneve shtetërore të Kosovës, qytetarë të shumtë dhe nxënës të shkollave të Prishtinës.

Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati iu bënë revistë kuadrateve të FSK-së.

Presidentja Atifete Jahjaga, kryetari i Parlamentit Jakup Krasniqi, kryeministri Hashim Thaçi dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta vendosen kurora me lule pranë Obeliskut të Dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri. Në manifestimin "Epopeja e UÇK-së", me nga një fjalë tematike u paraqitën presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi dhe në emër të familjes Jashari Bashkim Jashari.





FSK homazhe në Prekaz

Në përvjetorin e 16-të të rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari, ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me stafin e lartë të MFSK-FSK-së, bënë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, me këtë rast tha: "Jemi këtu së bashku me udhëheqësit e FSK-së për ta nderuar veprën heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit".





FSK-ja parakalon në Ditën e Pavarësisë së Kosovës

Në përvjetorin e gjashtë të shpalljes së Pavarësisë të Republikës së Kosovës, më 17.02.2014, në sheshin "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti" të Prishtinës, parakaluan kuadratet e të gjitha njësive të Forcës së Sigurisë të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës.
Në këtë manifestim kryeministri Thaçi tha:" Kjo është parada e fundit e FSK-së me këtë emër. Na ndan një kohë e shkurtër nga themelimi i Forcave të Armatosura të Kosovës, të cilat do të kenë mandat të ri dhe kapacitete mbrojtëse. Ato do të jenë të gatshme dhe të afta ta mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës".
Në këtë rast presidentja Jahjaga tha: "Në këtë gjashtë vjetor të Pavarësisë duhet të dëshmojmë se po ruajmë vlerat e gjeneratave të tëra që u sakrifikuan për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës. 17 Shkurti shënon historinë e pakthyeshme dhe të pamohueshme të shtetit të Kosovës. Periudha e hasmërive në Ballkan ka kaluar dhe tani është koha e integrimit në strukturat evropiane. Pavarësia e Kosovës është garantuese e paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajonin e Evropës Juglindore".
Sukseset e FSK-së i vlerësoi edhe ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovës, znj. Tracey Jacobson e cila solli mesazhin e presidentit të SHBA-ve, Barak Obama, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të përkushtuara për ta ndihmuar Kosovën drejt integrimeve euroatlantike dhe të ardhmes më të ndritur për të gjithë qytetarët e Kosovës, ndërsa për FSK-në tha se ka arritur suksesin më të madh me plotësimin e kapaciteteve të plota operacionale.



Ministri i FSK-së Agim Çeku në Konferencën "Karta e Adriatikut" në Mal të Zi



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), Agim Çeku, mori pjesë në Konferencën **e** Ministrave të Mbrojtjes të Ballkanit, "Karta e Adriatikut A-5", e cila u mbajt nga data 15 deri më 17 tetor 2014 në qytetin e Budvës në Mal të Zi. Ministri Çeku pati takime bilaterale me shumicën e ministrave të mbrojtjes, pjesëmarrës në Konferencën "Karta e Adriatikut". Gjatë konferencës, gjithashtu, ministri Çeku zhvilloi takime bilaterale edhe më përfaqësues të NATO-s, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe me kryeministrin e Malit të Zi.
Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Timoty Orr, morën pjesë në punimet e Konferencës së 18-të 'Karta e Adriatikut A-5' në Budvë (Mal të Zi). Në këtë konferencë morën pjesë shefat e Mbrojtjes të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, si dhe përfaqësues nga Komanda Amerikane për Evropë (EUCOM), zëvendës shefi i Mbrojtjes së Sllovenisë dhe komandantët e gardave kombëtare partnere me vendet e rajonit, përfaqësuesi i Komandës Kryesore të Gardës Kombëtare të SHBA-ve, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajoves, Nju Xhersit, Kolorados, Minesotes, Vermontit si dhe komandanti i KFOR-it. Gjeneral Kastrati pati takime të shumta bilaterale me përfaqësuesit e EUCOM-it, admiralin Charles W. Martoglio, kundëradmiralin Patric Piercey si dhe me pjesëmarrës të tjerë të konferencës.

Ministri i FSK-së pjesëmarrës në Konferencën e 50-të të Sigurisë në Gjermani

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), Agim Çeku, mori pjesë në punimet e Konferencës së 50-të të Sigurisë, e cila i zhvilloi punimet që nga 31 janari deri më 2 shkurt 2014 në Munih të Gjermanisë.
Në këtë konferencë u diskutuan disa çështje si: Mbrojtja e ardhshme evropiane, Procesi i paqes në Lindjen e Mesme, Katastrofa siriane, E kaluara, e tashmja dhe ardhmja e sigurisë ndërkombëtare, Dialogu Prishtinë-Beograd dhe çështje tjera të sigurisë evropiane dhe botërore.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati në konferencën e 22-të vjetore të ushtrive evropiane, në Wiesbaden të Gjermanisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i shoqëruar edhe nga kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, mori pjesë në konferencën e 22-të vjetore të ushtrive evropiane që u mbajt në Wiesbaden të Gjermanisë (15-17 shtator 2014) nën organizimin e "US Army Europe" (Ushtria e SHBA-ve për Evropë). Në këtë konferencë morën pjesë komandantë dhe personalitete udhëheqëse të ushtrive të Evropës si dhe komandanti i "US Army Europe", gjenerallejtënant Donald M. Campbell. Punimet e konferencës u zhvilluan në pesë sesione me tema të ndryshme.



Konferencë ndërkombëtare “Mbrojtja e mençur, ndarje, bashkim dhe iniciativë”

Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë, z. Bejtush Gashi dhe drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Faruk Geci, morën pjesë në konferencën ndërkombëtare, “Mbrojtja e mençur, ndarje, bashkim dhe iniciativë”, të mbështetur nga Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s dhe të organizuar nga Këshilli Euro-Atlantik i Maqedoninë. Konferenca zhvilloi punimet nga data 17 deri më19 tetor 2014 në Strugë të Republikës së Maqedonisë.

Në konferencë u paraqitën pikëpamje dhe mendime për çështjet tematike, u ofruan rekomandime për SHBA-Kombet e Kartës së Adriatikut dhe kombeve të interesuara për anëtarësim në kuadër të “Adriatik-5” për zhvillimin e ardhshëm të qasjes rajonale “Mbrojtja inteligjente” si dhe mundësitë e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral.

Ministri dhe Komandanti i FSK-së pritën ndihmës Sekretaren e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës Dr. Evelyn Farkas



Ministri Çeku informoi ndihmës sekretaren e Mbrojtjes z. Farkas me zhvillimin aktual në FSK dhe angazhimet për ngritje dhe profesionalizim e më tejmë në përputhje edhe me rekomandimet e Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës. Ai, ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për zhvillimin dhe rritën e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ndërsa, ndihmës sekretarja e Mbrojtjes z. Farkas premtoi se edhe në të ardhmen SHBA-të do ta ndihmojnë dhe mbështesin FSK-në në transformimin e saj në Forcë të Armatosur të Kosovës. Theks të veçantë në këtë takim iu kushtua stërvitjes, shkollimit dhe edukimit të pjesëtarëve të FSK-së. Të dyja palët u pajtuan se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen përmes programeve të partneritetit me Gardën Kombëtare të Iowas dhe Ambasadës amerikane.



Zëvendëskomandanti suprem i Aleancës së NATO-s për Evropë vizitoi MFSK-në

Ministri Agim Çeku priti zëvendëskomandantin suprem të Aleancës së NATO-s për Evropë, gjeneral Sir Adrian Bradshaw, të cilin e informoi me të arritur e FSK-së. Ministri Çeku kërkoi ndihmën e NATO-s për ngritjen e kapaciteteve ushtarake të mbrojtjes, vendosjen e raporteve formale të partneritetit (anëtarësimi në Partneritet për Paqe-PFP), qasje në shkolla të NATO-s, si dhe pjesëmarrje në misione paqeruajtëse të NATO-s. Ministri Çeku e siguroi gjeneralin Adrian Bradshaw se Kosova po ecën drejt marrjes së përgjegjësive për sigurinë e vetë dhe se ajo gjithashtu ka nevojë për mbështetjen, asistencën dhe këshillën e NATO-s, në mënyrë që të evoluojmë bashkë me NATO-n, duke ditur edhe faktin se populli i Kosovës dhe Qeveria e vendit e ka synim anëtarësimin në NATO. Gjenerali Adrian Bradshaw, tha: “NATO e çmon aspiratën e Kosovës për anëtarësim në NATO dhe gatishmërinë e saj për të kontribuar në misione paqësore. FSK-ja do të ecë përpara në ngritjen e kapaciteteve të saj dhe se bashkëpunimi dhe mbështetja nga ana e NATO-s, nuk do të mungojë”.Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për nderë të gjeneralit të NATO-s, organizoi ceremoni zyrtare dhe e veçanta e kësaj ishte se Njësia Ceremoniale e FSK-së, për herë të parë ka veshur uniformën e re tradicionale.

MFSK dhe Forcat e Armatosura të Turqisë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Shkëlzen Sylaj, së bashku me një delegacion të MFSK-së, gjatë vizitës tri ditore në Republikën e Turqisë, nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit-Protokollit, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për trajnim dhe bashkëpunim në fushën e shëndetësisë ushtarake. Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës marrëveshjen e nënshkroi sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Shkëlzen Sylaj, ndërsa në emër të Qeverisë të Republikës së Turqisë –Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë- shefi i Logjistikës, gjenerallejtënant Atilla Gülan. Marrëveshja për bashkëpunim në mes të MFSK-së dhe Forcave të Armatosura të Turqisë, në fushën e shëndetësisë ushtarake, parasheh bashkëpunimin në fushat e trajnimit universitar të mjekësisë ushtarake, arsimimit itë lartë të mjekësisë profesionale për nënoficerë, arsimimit të lartë të infermierisë si; trajtimi shëndetësor falas i pjesëtarëve të MFSK-së; shkëmbimi i instruktorëve, këshilltarëve, vëzhguesve, personelit të specializuar, stafit akademik dhe studentëve, trajtimi i pacientëve, bashkëpunimi në fushën e logjistikës mjekësore e aktivitete tjera.



Drejtori për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë Steve Mc Carthy vizitë në MFSK



Ministri i FSK-së, z.Agim Çeku, më 5 qershor, priti drejtorin për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë të Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, z. Steve Mc Carthy, i cili shoqërohej nga ambasadori Ian Cliff. Ministri Çeku e informoi mysafirin me rezultatet e arritura, zhvillimin aktual të FSK-së dhe angazhimet për ngritje dhe profesionalizim të mëtejmë në përputhje edhe me rekomandimet për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë të Kosovës - RSSSK. Nga ana e tij, drejtori Mc Carthy shprehu gatishmërinë për vazhdimin e përkrahjes së FSK-së nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, sidomos në zhvillimin e bashkëpunimit me NATO-n drejtë ngritjes së partneritetit formal.

Konferenca e përbashkët e bashkëpunimit "FSK dhe Partnerët"



Në ambientet e reja të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 30 tetor 2014, u mbajt Konferencë e përbashkët e bashkëpunimit "FSK-ja dhe partnerëtP. Në konferencë morën pjesë: ministri i MFSK-së, Agim Çeku, zëvendësministrat Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, oficerë dhe zyrtarë të lartë të MFSK-së, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Peter Braunstein, drejtori i NAT-it, z. Kevin Lynch, përfaqësues të Ambasadës Amerikane, atashetë ushtarakë të akreditуar në Kosovë, përfaqësues të NATO-s, të NLAT-it, si dhe përfaqësues ushtarakë të ushtrive të regjionit. Punimet e konferencës i hapi kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë për FSK-në. Në Konferencën e përbashkët për bashkëpunim me partnerët u mbajtën tri prezantime: Procesi i implementimit dhe planifikimit strategjik në MFSK pas rekomandimeve të RSSS-së; Procesi i planifikimit operacional; prioritet dhe koncepti i trajnimit dhe Bashkëpunimi ndërkombëtar. Ministri i MFSK-së, Agim Çeku, me këtë rast, përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit si dhe falënderoi për ndihmën e vazhdueshme që kanë dhënë dhe po japin për ngritjen profesionale të FSK-së, zhvillimin dhe transformimit të saj në Forcat e Armatosura të Kosovës. Ne jemi duke punuar shumë në kuadër të misionit aktual të FSK-së si dhe në planifikimin e ngritjes së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Kosovës. Parimi ynë i bashkëpunimit është transparenca me të gjithë partnerët tanë si dhe me qytetarët. Në fund të fjalës së tij, ministri Çeku, tha: "Ne e dimë vlerën e ndihmës tuaj, sukseset i kemi arritur së bashku me ju, po ashtu edhe në të ardhmen kemi nevojë për mbështetjen tuaj si partnerë dhe anëtarë të NATO-s". Me nga një referencë, më pastaj u paraqiten, gjeneral brigade Peter Braunstein, drejtor i NLAT-it, (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s), oficeri i Ushtrisë Amerikane Robert Matthewson me mision në NATO, Kevin Lynch, drejtori i NAT (Ekipit Këshillues të NATO-s) .

Komandanti i Forcave Tokësore të Republikës së Turqisë gjeneral Akar në FSK



Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjenerali me katër yje Hulusi Akar u prit nga ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Gjenerali Akar u prit me nderime nga togu ceremonial i FSK-së. Gjeneral Kastrati e njoftoi gjeneralin Akar me zhvillimin dhe të arriturat e Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe me procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Kosovës(RSSS) dhe çështje tjera relevante. Nga ana e tij, gjeneral Hulusi Akar u shpreh i lumtur që gjendet në mes miqsh, Ai shprehu gatishmërinë për ta mbështetur edhe më tutje FSK-në me shkollime, trajnime si dhe pajisje. Ai njëherësh shprehu mbështetje për Kosovën në mekanizmat ndërkombëtarë dhe në NATO.

Kundëradmirali suedez Odd Werin vizitoi MFSK-në

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati pritën në takim shefin e delegacionit të Suedisë në NATO, kundëradmiralin Odd Werin me bashkëpunëtorë. Në takim u vlerësua lartë bashkëpunimi i mirë i MFSK-së me shtetin e Suedisë, shërbimi i kontingjentit të Forcave të Armatosura të Suedisë në kuadër të KFOR-it në Kosovë, mbështetja e pakursyer e këshilltarëve suedez në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s për MFSK-në në fushën e bashkëpunimit ushtarako-civil, në fushën e të drejtave të njeriut dhe në fushën e deminimit humanitar.



Gjeneralë të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë në Ministrinë e FSK-së



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 21 mars 2014, priti një delegacion të gjeneralëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në krye me gjenerallejtënant Musa Avsaver, shef i komunikimit në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Turqisë (FART).

Komandanti i Komandës së Forcave të Bashkuara të Aleancës në Napoli admirali Bruce Clingan në MFSK



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku, më 21 korrik, priti në vizitë komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara të Aleancës (KFBA) në Napoli, admiralin Brus Clingan, si dhe pasardhësin e tij në detyrë admiralin Mark Ferguson III, të shoqëruar edhe nga komandanti i Forcave Paqeruajtëse të KFOR-it, gjeneral major Salvatore Farina Ministri Çeku, admiralët Clingan dhe Ferguson, i njoftoi për procesin e implementimit të rekomandimeve të dala nga procesi i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Nga ana e tij, admirali Clingan shprehu interesimin dhe angazhimin e tij të pakursyer për përkrahjen e FSK-së, në rrugën e zhvillimit. Ai u shpreh gjithashtu se Komanda e Bashkuar e Forcave të Aleancës në Napoli, me vëmendje po përcjellë zhvillimet në Republikën e Kosovës për sa i përket fushës së sigurisë dhe se Napoli është i bindur se Kosova është në rrugë të drejt. Admirali Clingan tha se pasardhësi i tij në detyrë, admirali Ferguson, është shumë i interesuar që bashkëpunimi në mes të KFBA-së në Napoli dhe FSK-së të vazhdojë edhe në të ardhmen, ashtu siç ka qenë deri më tani.

Komandanti i FSK-së priti një delegacion amerikanë të EUCOM-it

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, së bashku me komandantin e Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama dhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e FSK-së, priti një delegacion të oficerëve të lartë amerikanë të EUCOM-it, (Komanda Amerikane për Evropë) të prirë nga kundëradmirali Patrick Piercey, zëvendës i Departamentit për Politika dhe Plane në EUCOM dhe kundëradmirali Marc Dalton me bashkëpunëtorë. Qëllimi i takimit të sotëm ishte vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet EUCOM-it dhe FSK-së, njëherësh ky ishte edhe takim njohës me zëvendësin e kundëradmiralit Patrick Piercey, kundëradmiralin Marc Dalton.





Ministri dhe Komandanti i FSK-së e dekoruan me medalje Komandantin e Gardës Kombëtare të AJOVES

Ministri Agim Çeku dhe komandanti Kadri Kastrati pritën, në takime të ndara, komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës , gjeneralmajorin Timothy Orr me bashkëpunëtorë.
Me këtë rast, ministri për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Agim Çeku, në shenjë mirënjohje dekoroi komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralin Timothy Orr me medalje "Për shërbim meritor, për kontribut të jashtëzakonshëm, partneritet dhe mbështetje të vazhdueshme në zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në një institucion profesional, kompetent dhe të aftë".

Gjenerali Martin Dempsey i uron gjeneral Kastratit Ditën e Pavarësisë

Kryesuesi i Shefave të Shtabeve të Bashkuara të Ushtrisë Amerikane, gjeneral Martin Dempsey, përmes një letre, i uroi komandantit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastratit, Ditën e Pavarësisë, në të cilën thuhet: "Në emër të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në emër të Komandës së Bashkuar të Shefave të Shtabeve, ju përgëzoj Ju dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës me rastin e Ditës së Pavarësisë".

Ambasadori i SHBA-ve në NATO, Douglas Edward Lute në FSK



Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agim Ceku, priti ambasadorin e SHBA-ve në NATO, Douglas Edward Lute, të shoqëruar nga ambasadorja e SHBA-ve në Kosovë, Tracey Ann Jacobson dhe anëtarë të tjerë të delegacionit.
Ministri Agim Çeku e njoftoi ambasadorin Lute me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të posaçëm foli për punën që është bërë në Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë. Duke falënderuar ambasadorin Lute për kontributin e tij në NATO në përkrahje të FSK-së, ministri Çeku kërkoi nga ai që të përkrahet angazhimi i MFSK-së dhe Kosovës për anëtarësim në Programin e Partneritet për Paqe të NATO-s.



Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën admiralin e NATO-s Bruce Clingan

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më 4 shkurt 2014, pritën komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara të NATO-s, admiralin Bruce W. Clingan.
Ministri Çeku e falënderoi admiralin Clingan për mbështetjen që NATO-ja i ka dhënë MFSK-së dhe FSK-së, përmes Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s, si dhe për punën e shkëlqyer të KFOR-it si një forcë stabilizuese në Kosovë.
Ministri Çeku e informoi admiralin Clingan për zhvillimet e fundit, gjithashtu edhe për vendimin e Qeverisë për të ardhmen e FSK-së. Ai theksoi faktin se këto zhvillime të reja janë në interes të Kosovës dhe të bashkësisë ndërkombëtare.

Gjeneral Kastrati dhe gjenerali amerikan Timothy Orr përcjellin demonstrimin e njësisë së kërkim-shpëtimi

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajorin Timothy Orr, përcollën nga afër demonstrimin e shkathtësive taktike të pjesëtarëve të FSK-së në Pomozotin, lëshimin me litarë dhe dhënien e ndihmës personave në nevojë, ndërsa në Istog pjesëtarët e BRSH-së demonstruan shkathtësitë e tyre taktiko-luftarake.





Marrëveshje bashkëpunimi në mes Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve dhe MFSK-së

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Agim Çeku dhe zëvendës ambasadorja e SHBA-ve në Republikën e Kosovës, znj. Jennifer Bachus, në ambientet e Ministrisë, nënshkruan Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
Marrëveshja ka për qëllim krijimin e kushteve themelore dhe procedurave tjera për të lehtësuar ofrimin reciprok të mbështetjes logjistike, furnizimeve dhe shërbimeve të tjera, kryesisht gjatë ushtrimeve të kombinuara, trajnimeve, dërgimit-dislokimit të trupave, transportit detar, operacioneve, por edhe në rastet e tjera të bashkëpunimit si në rrethana të paparashikuara ose urgjencave në të cilat njëra prej Palëve mund të ketë nevojë për mbështetje logjistike, furnizime, dhe shërbime. Marrëveshja ka përcaktuar kushtet në bazë të të cilave të dyja palët do t'i realizojnë të drejtat dhe do t'i përmbushin detyrimet/obligimet e tyre, ku secila palë do të bëjë përpjekjet e

FSK në Konferencën e Historisë Ushtarake në Gjermani

Një delegacion i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i prirë nga kolonel Skënder Zhitia, shef i Departamentit të Personelit, më 4 qershor 2014, mori pjesë në Konferencën e 55-të Ndërkombëtare të Historisë Ushtarake në Potsdam të Republikës Federale të Gjermanisë. Në këtë konferencë u prezantua tema: "Dinamika e globalizimit, Rajhu gjerman ndërmjet konfliktit shtetëror evropian dhe Lufta Botërore 1914-1918."
Në Konferencë u trajtuan aspektet strategjike dhe historike të Luftës së Parë Botërore dhe ndikimin që kanë pasur ato në vitet pasuese. Pjesëmarrës të kësaj konference ishin përfaqësues të instituteve të historisë ushtarake nga vende të ndryshme.



Atasheu amerikan i Mbrojtjes nderohet me medalje



Ministri Agim Çeku nderoi me medalje atasheun ushtarak amerikan të Mbrojtjes, kolonelin James Kott, me rastin e përfundimit të misionit të tij si atashe i Mbrojtjes i akreditуar në Republikën e Kosovës. Në aktivitetin festiv, të organizuar me rastin e përcjelljes se kolonelit Jams Kott, ishin rreshtuar Togu Ceremonial i FSK-së, Kuadratet e Njësive të FSK-së dhe Bendi Muzikor. Në ceremoni morën pjesë edhe ambasadorja e SHBA-ve në Republikën e Kosovës, znj. Tracy An Jakobson, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjeneral major Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralët Zymer Halimi, Gëzim Hazrolli dhe Enver Cikaqi, atasheu i radhës i Mbrojtjes, kolonel Chad Butts, atashe ushtarak të akreditуar në Kosovë, si dhe oficerë e zyrtarë tjerë të lartë të FSK-së dhe të Ambasadës Amerikane në Republikën e Kosovës.

Komandantin i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati u prit me nderime ushtarake në Tiranë

Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të Shqipërisë, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Për nder të komandantit të FSK-së ishte rreshtuar Garda e Nderit të FA të Shqipërisë. Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, u prit edhe nga ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli. Në pritjen e organizuar për nder të gjeneral Kastratit mori pjesë stafi i lartë i FA të Shqipërisë, po ashtu ishte i pranishëm nga FSK-ja, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe atasheu ushtarak i Kosovës në Tiranë, nënkolonel Enver Dugolli. Gjatë takimit u shpreh dimensioni i shtuar i bashkëpunimit të Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës në të gjitha fushat si dhe në fushën kulturore-sportive.





Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes u certifikuan kadetët nga SHBA dhe FSK-ja

Në kazermën "Skënderbeu" të FSK-së, në Ferizaj, më 8 gusht 2014, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së dhe kadetëve amerikanë, të cilët bashkërisht realizuan kursin për zhvillimin dhe avancimin e gjuhës angleze dhe bashkëpunimin për mësimin e kulturave të ndryshme. Në këtë ceremoni morën pjesë: Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Enver Cikaqi, kryetari i Komunës së Ferizaj Muharrem Sfarqa, atashehu ushtarak i Ambasadës Amerikane kolonel Chad Butts, përfaqësues të NLAT (Ekipi Ndërlidhës Këshillues i NATO-s), si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it, drejtori i instruktorëve nga SHBA, Robert Lyle.
Komandanti i FSK-së gjeneral Kastrati tha: "Programi i kuptimit të kulturës dhe përmirësimit të gjuhës angleze (CULP), është njëri ndër trajnimet që zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit bilateral që FSK-ja ka me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ky program është një mbështetje shtesë që Ushtria e SHBA-ve është duke ofruar për FSK-në, përmes trajnimeve për përmirësimin e nivelit të komunikimit në gjuhën angleze".


FSK në ushtrimin e përbashkët "Përgjigjja e menjëhershme 2014" në Sllloveni

Për të përcjellë demonstrimin e ushtrimit në Sllloveni ishin te pranishëm edhe komandanti i KFT-së, gjeneral Rama dhe drejtori i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim kolonel Ilir Qeriqi. Në ushtrimin fushor "Përgjigje e menjëhershme 2014", morën pjesë tri ekipe të specializuara të FSK-së me 24 pjesëtarë dhe dy automjete. Ushtrimi është zhvilluar në Republikën e Sllovenisë në tri lokacione: në Postojna, Vipava dhe Mahnice. Ekipet e FSK-së kanë treguar profesionalizëm në operacionet e kërkim-shpëtimit, deminimit dhe ato të mjekësisë. Gjatë demonstrimit të




FSK testoi kapacitetet operacionale të njësive në terren

Në ambientet e ish-kazermës së FSK-së në Pejë, u përmbyll me sukses cikli i ushtrimit fushor "Shqiponja 3", përmes të cilit u bë testimi i kapaciteteve operacionale të Brigadës për Mbështetje Operacionale dhe njësive pranë Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) të Forcës së Sigurisë. Për të përcjellë nga afër operacionet përfundimtare të ushtrimit "Shqiponja 3" në zonën e operacionit, ishin ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministri Bejtush Gashi, zëvendëskomandanti njëherësh komandant i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, z. Shkëlzen Sylaj, të gjithë gjeneralët e FSK-së, atashetë ushtarak të akreditуar në Kosovë, përfaqësues të KFOR-it, të NAT-it, NLAT-it si dhe të ftuar të tjerë.
Në Komandën e vend incidentit të ushtrimit "Shqiponja 3", prezantimin për rrjedhën e përgjithshme të operacioneve para ministrit, komandantit dhe eprorëve të lartë e bëri drejtori i ushtrimit, kolonel Naim Haziri, shef i Shtabit të KFT-së. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në fjalën e tij i përgëzoi veçanërisht ushtarët, nënoficerët dhe oficerët të cilët treguan profesionalizëm, vullnet dhe disiplinë për të realizuar të gjitha objektivat e parashikuara të ushtrimit fushor "Shqiponja 3". Ai, me këtë rast, tha: "Stërvitja e pjesëtarëve dhe e njësive të FSK-së, është objektiv dhe prioritet kyç i imi dhe i komandantëve në të gjitha nivelet. Ushtrimi fushor „Shqiponja 3" është finalizim i suksesshëm i ciklit të stërvitjeve individuale dhe kolektive të FSK-së, për këtë vit, dhe tregues i gatishmërisë së lartë operacionale të njësive të FSK-së. Gjeneral Kastrati, më këtë rast, theksoi edhe pjesëmarrjen e FSK-së, në ushtrimin e përbashkët jashtë vendit në Slloveni, ku pjesëtarët tanë kanë treguar profesionalizëm, disiplinë dhe përkushtim të lartë. Këto ushtrime janë tregues se FSK-ja është e gatshme të kryej dhe zbatojë të gjitha detyrat që i jepen nga institucionet qendrore të vendit, përfshirë edhe shndërrimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës".



Ushtari më i mirë i FSK-së - tetar Binak Podrimçaku

Në kazermën "Adem Jashari" të FSK-së u mbajt ceremonia e shpalljes së ushtarit më të mirë të FSK-së për këtë vit. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratri, në këtë ceremoni tha: "Gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë është një ngjarje e veçantë, sepse u organizua për herë të parë në kuadër të FSK-së. Këto disiplina janë standardet, që neve sot si FSK, kurse nesër si Forcë e Armatosur, do të na çojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e standardeve që duhet t'i arrijmë në të ardhmen. Shpirti garues i çdo njërit në FSK, duhet të jetë shumë i fuqishëm, në mënyrë që të ecim përpara drejt arritjes së qëllimeve tona të përbashkëta, që të jemi krah për krah me shtetet e NATO-s." Pas garës, ushtari më i mirë u shpallë toger Binak Podrimçaku, me gjithsej 538 poenë nga Brigada e Reagimit të Shpejtë në Istog, vendin e dytë e zuri ushtari Kushtim Abazi më 504 poenë, pjesëtar i BRSH-së në Istog, ndërsa vendin e tretë e zuri tetari Migjen Basha, me gjithsej 487 poenë, pjesëtar i Brigadës për Mbështetje Operacionale.





Intervenimi i suksesshëm i FSK-së në Termocentralin "Kosova A"

Me urdhër të gjenerallejtënant Kadri Kastratit, Forca e Sigurisë së Kosovës ka angazhuar njësitë e saj në operacion, pas fatkeqësisë me rastin e shpërthimit të bombolës së hidrogjenit në Repartin e Elektrolizës të Termocentralit "Kosova A" të Korporatës Energjetike të Kosovës. Pjesëtarë të Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, pas shpërthimit të bombolës së hidrogjenit në Repartin e Elektrolizës në Termocentralin "Kosova A" në Kastriot, kanë arritur që të nxjerrin nga rrënojat trupat e pa jetë të dy personave dhe të një të mbijetuari nga vendi i fatkeqësisë.
Në të njëjtën kohë Kompania e Mbrojtjes Kimike, Atomike dhe Biologjike (MKAB) ka vlerësuar situatën nga rreziku i shpërthimeve tjera. Në operacion kanë marrë pjesë 65 pjesëtarë dhe 21 automjete, nga Njësia e Kërkim- Shpëtimit, Kompania e Mjekësisë, MKAB, Ndërlidhjes, Njësia për Reagim ndaj Krizave, Policia e FSK-së etj. E para, Kompania e Mbrojtjes Kimike, Atomike dhe Biologjike ka bërë vlerësimin profesional të situatës në zonën e shpërthimit dhe ka vlerësuar se nuk ka rrjedhje të mëtutjeshme dhe se nuk ka rrezik për ndonjë shpërthim tjetër eventual. Këtë vlerësim e kanë konfirmuar bashkërisht edhe ekspertët e Policisë së Kosovës dhe ata të KEK-ut. Pas vlerësimit të situatës në zonën e incidentit, FSK-ja ka angazhuar pjesëtarë të Kompanisë së Kërkim-Shpëtimit. Intervenimi i njësive të FSK-së në KEK, ka rezultuar i suksesshëm.



Pjesëtarët e MKABK-së trajnohen me sukses në Bullgari



Një tog i FSK-së prej 22 pjesëtarësh përfunduan trajnimin 6 javor (Planifikimi i Emergjencave Civile) në Bullgari.
Qëllimi i këtij trajnimi ishte përgatitja e pjesëtarëve të FSK-së, në mënyrë sa më profesionale dhe sipas standardeve më të larta të kërkuara për Mbrojtjen Kimike, Atomike dhe Biologjike (MKAB).
Trajnim është realizuar në bazë të ofertës së Ministrisë së Mbrojtjes të Bullgarisë. Ky ishte grupi i dytë i pjesëtarëve të RMC-së (MKABK) që kryejnë trajnime profesionale në bazat Ushtarake të Bullgarisë.

Diplomoi gjenerata e gjashtë e kadetëve të FSK-së

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj u mbajt ceremonia e diplomimit të kadetëve të FSK-së, gjenerata 2014. Në ceremoni morën pjesë: ministri i FSK-së Agim Çeku, ministri i Ministrisë të Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, zëvendësministri Bejtush Gashi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneralmajor Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së z. Shkëlzen Sylaj dhe gjeneralët: Nazmi Brahimaj, Zymer Halimi, Enver Cikaqi si dhe qytetarë të shumtë. Gjeneral Kastrati, me këtë rast, u shpreh krenar për faktin se tani Qendra për Studime Universitare (QSU) ka krijuar traditën e përgatitjes së oficerëve të rinj, të edukuar dhe të ngritur profesionalisht, të cilët do t'i bashkohen trupës së oficerëve të FSK-së, për të mbajtur dhe zhvilluar edhe më tutje gatishmërinë operacionale të FSK-së. Kadetët e sapo diplomuar u graduan me gradën e nëntogerit.



MFSK-së dhe Ministria e Mbrojtjes së Maqedonisë memorandum për shkëmbimin e ekspertëve



Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Saso Stafanoski, sekretar i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi lidhur me shkëmbimin e ekspertëve. Ky memorandum paraqet një kornizë për bashkëpunim dhe shkëmbim të ekspertëve të certifikuar për të kryer trajnime në fushën e çështjeve publike dhe është arritur në bazë të marrëveshjes që kanë këto dy ministri në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë që nga vitit 2010.

Kadetët e FSK-së pjesë e "Kampit Veror 2014" në Krivollak të Maqedonisë

Me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, më 10 qershor 2014, një njësit i kadetëve të FSK-së mori pjesë në ushtrimin fushor "Kampi Veror 2014" që u mbajt në Poligonin Ushtarak në Krivollak të Maqedonisë.
Në ushtrimin "Përpjekja gjithëpërfshirëse e kombinuar për ndërtimin e paqes", përveç kadetëve të FSK-së, morën pjesë edhe kadetët e 10 shteteve të tjera rajonale. Komandanti i KFT-së, gjeneral Rama tha: Kjo është një ngjarje jashtëzakonisht e rëndësishme për FSK-në për arsye se për herë të tretë kadetët e FSK-së po marrin pjesë në Qendrën për Trajnime në Krivollak të Maqedonisë, duke ndërtuar ura njohjeje dhe bashkëpunimi me kolegë të vendeve të ndryshme, pa paragjykime të përkatësive nacionale. Pjesëmarrja e kadetëve të FSK-së, në ushtrimin ndërkombëtar në Maqedoni, është dëshmi e një bashkëpunimi të mirë me Ministrinë e Mbrojtjes të Maqedonisë dhe përpjekje e vazhdueshme e MFSK-së për bashkëpunim të ngushtë rajonal dhe me gjerë në fushën e sigurisë.



Pjesëtarët e FSK-së trajnohen për Operacione Paqësore

Në Brigadën për Mbështetje Operacionale të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), u certifikuan 30 pjesëtarë të FSK-së, të cilët përfunduan me sukses trajnimin për "Operacione Paqësore", të mbajtur dhe të organizuar nga ekipi i instruktorëve të Qendrës për Trajnime të Republikës së Turqisë (PfP-Partnership for Peace Training Center).Komandanti i FSK-së, gjeneral Kastrati, falënderoi ekipin e instruktorëve të Turqisë për bashkëpunimin e mirëfilltë ndërmjet FSK-së dhe Armatës së Turqisë. Ai njëherësh vlerësoi lart kontributin e madh të ekipit të Forcave të Armatosura të Turqisë për realizimin e synimit të FSK-në ngritjen e kapaciteteve profesionale të saj sipas standardeve të NATO-s.



Kadetë e FSK-së trajnohen për Kërkim-Shpëtim në dimër

Kadetët e FSK-së përfunduan një trajnim të kërkim-shpëtimit në kushte dhe rrethana dimri. Pjesën teorike e zhvilluan në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, ndërsa pjesën praktike në malet e fshatit Strazhë, Komuna e Kaçanikut. Trajnimi është mbajtur gjatë muajve janar-shkurt 2014 dhe është realizuar nga instruktorët e Qendrës Specialistike të Stërvitjes (QSS) të FSK-së. Gjatë trajnimit një mujor janë realizuar me sukses temat rreth menaxhimit të kërkim-shpëtimit në dimër, topografisë dhe ndihmës së parë.

Kadetët e FSK-së në ushtrimin fushor "Vjeshta 2014"



Bazuar në planin kalendarik të trajnimeve, njësitet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), janë duke realizuar trajnime të ndryshme. Qendra e Studimeve Universitare (QSU) ka realizuar ushtrimin fushor të koduar me emrin "Vjeshta 2014". Pjesa teorike e trajnimit është realizuar në hapësirat e kësaj qendre nga instruktorët e KDS-së, ndërsa pjesa praktike në ambientet e kazermës "Skënderbeu" prej datës 10 deri më 12 tetor 2014.

Betimi i kadetëve të rinj të FSK-së

Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, më 10 shtator 2014, u zhvillu ceremonia e dhënies së betimit dhe fillimi i vitit të ri akademik 2014-2015, të 13 kadetëve të Qendrës për Studime Universitare (QSU) të FSK-së, gjenerata 2018.



Kompania e deminimit gjatë vitit 2014, shkatërroi mbi 1000 mjete të pashpërthyera



Kompania e deminimit të FSK-së,gjatë vitit 2014, ka pastruar mbi 346577 metra katrorë sipërfaqe të minuara në pesë lokacione dhe ka shkatërruar 573 mjete të pashpërthyera si: mina, mortaja, bomba kasetore, projektil, granata, etj. Ndërsa,Ekipet e Shkatërrimit të Mjeteve të Pashpërthyera (EOD)të cilët kujdestarojnë 24 orë në 7 ditë, kanë shkatërruar 434 mjete të pashpërthyra.

Kompania e Deminimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) ka filluar operacionet e çminimit dhe pastrimit të fushëbetejave në pesë lokacione në gjithë territorin e Kosovës, ku ende ka fusha të minuara dhe mbetje të mjeteve eksplozive nga betejat. Kompania e Deminimit, sipas komandantit të saj kapiten Sejdi Krasniqi, ka në terren pesë ekipe çminuese: në Gorancë të Hanit të Elezit, ku filloi operacioni i deminimit humanitarë, me ç'rast do të bëhet çminimi i zonave të minuara, si dhe në katër lokacione tjera do të kryhet pastrimi i fushëbetejave (BAC). Lokacionet në të cilat ekipet e deminimit kanë bërë pastrimin e fushëbetejave janë: Ambientet e kazermës së FSK-së në Ferizaj, Parku i Lirisë po ashtu në Ferizaj, në Luzhnicë të Suharekës dhe Nivokaz të Gjakovës. Nga viti 2010 FSK-ja ka çminuar dhe pastruar nga minat 820 mijë e 428 metra katrorë sipërfaqe si dhe ka demoluar dhe shkatërruar mbi 10 mijë e 95 mina dhe mjete tjera eksplozive, të gjitha këto në kuadër të deminimit humanitar. Ekipet për eliminimin e mjeteve të pashpërthyera (EOD) kanë pranuar 1167 thirrje për intervenim.Në gjitha thirrjet është intervenuar dhe si rezultat janë demoluar dhe shkatërruar 1990 mina dhe mjete tjera eksplozive.

Certifikohen deminerët e FSK-së, niveli 3

Në ambientet e kazermës "Lidhja e Prizrenit" të Kompanisë së Deminimit të FSK-së në Prizren, u organizua ceremonia e diplomimit të deminerëve të FSK-së, të cilët kanë kryer kursin e EOD-(Eliminimi i Mjeteve të Pashpërthyera) niveli 3. Në ceremoni morën pjesë: komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionele gjeneral brigade Ilaz Dërguti, komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, koloneli i KFOR-it amerikan, Evan Trinkle nga kampi Bondstell si dhe përfaqësues të lartë të FSK-së dhe të KFOR-it amerikan.



Komandanti i Kompanisë së Deminimit, kapiten Sejdi Krasniqi, i njoftoi të pranishmit për mbajtjen e këtij kursi. Kursi specialistik i EDO-së 3 është mbajtun nga instruktorët e KDS-QSS-së dhe instruktorët e specializuar të EOD-së, të KFOR-it amerikan. Kursi i Eliminimit të Mjeteve të Pashpërthyera filloi më 08 shtator 2014 dhe përfundoi më 09 tetor 2014.

Pjesëtarët e FSK-së dhuruan gjak për qytetarët e Kosovës



Nën organizimin e Departamentit të Mjekësisë, Departamentit për Bashkëpunim Civil-Ushtarak të MFSK-së dhe në koordinim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës, edhe këtë vit u mbajt aksioni humanitar për dhurimin e gjakut, me moton: "Dhuroni gjak-shpëtoni jetë". Fadil Mahmuti, menaxher i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut me këtë rast tha: "Pjesëtarët e FSK-së janë donatorët më të rregullt të gjakut që i janë përgjigjur çdo herë me vullnet këtij aksioni. FSK-ja i ka dhënë përkrahje maksimale këtij aksionit. Pjesëtarët e saj gjatë këtij aksioni kanë qenë shembulli më i mirë prej të gjithëve. Për neve, gjithmonë, është një kënaqësi e veçantë kur ndodhemi në mesin e ushtarëve dhe oficerëve të FSK-së, të cilët presin në radhë për dhurimin e gjakut". Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut ka filluar me 4 gusht dhe ka zgjatur deri më 14 gusht 2014. Nga pjesëtarët e FSK-së janë dhuruar qindra doza gjak të cilat do të jenë në shërbim të gjithë atyre që kanë nevojë për të.

FSK-ja ngriti urën mobile në fshatin Krushevë të Klinës

Batalioni i Xhenios i FSK-së më 22 prill ka filluar ndërtimin e një ure mobile në fshatin Krushevë e Vogël të Komunës së Klinës dhe e ka përfunduar më 16 maj. Ura mobile e montuar mbi lumin Drini i Bardhë është e gjatë 33 metra, e gjerë 4.5 metra dhe mbanë peshë deri në 20 ton Kjo është ura e dytë e kësaj madhësie, pas asaj në Kramovikë, të cilin e ngritën pjesëtarët e Batalionit të Xhenios. Prerjen e shiritit në mënyrë simbolike e bënë ministri i MFSK-së, z. Agim Çeku, kryetari i Komunës së Klinës z. Sokol Bashota dhe kryetari i fshatit z. Llesh Skelaj.



Rruga në fshatin Bllagagjë, vepër e FSK-së

Batalioni i Xhenios i FSK-së, në kuadër të zhvillimit të projekteve dhe bashkëpunimit civil-ushtarak, realizoi edhe një projekt në fshatin Bllagagjë të Komunës së Istogut, ku ndërtoi rrugën dy kilometra të gjatë. Në ceremoninë e përurimit të kësaj rruge ishin edhe ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Nenad Rashiq, zëvendësministrja e FSK-së, Jasmina Vasiq, kryetari i Komunës së Istogut Haki Rugova, komandanti i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Ilaz Dërguti, oficerë të FSK-së dhe përfaqësues të komunitetit serb. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, falënderoi pjesëtarët e Batalionit të Xhenios për punën e madhe që kanë bërë dhe po bëjnë kudo në Kosovë.



FSK-ja ndërtoi rrugën në fshatin Zebincë të Artanës

Batalioni i Xhenios i FSK-së, ndërtoi rrugën me gjatësi prej 1.9 km në fshatin Zebincë të Artanës. Ky projekt është financuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndërsa është zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Në ceremoni kanë marrë pjesë: Zëvendës ministri i MFSK-së, Muhamet Latifi, zëvendëskomandanti i KFT-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i KFOR-it, gjenerali Selvatore Farina, shefi i Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës të NATO-s (NLAT), gjeneral brigade Udo Schnittker, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, z. Ian Cliff, zëvendës shefi për bashkëpunim nga Zyra e BE-së në Kosovës, z. Mevlin Asin, kryetari i Komunës së Artanës, Svetislav Ivanoviq, ministri i Ministrisë për Kthim të Komuniteteve, Dalibor Jeftiq, përfaqësues të IOM-it, oficerë të KFOR-it dhe të FSK-së, banorë të fshatit, etj. Zëvendësministri i MFSK-së, Muhamet Latifi tha: "FSK-ja deri më tani ka kryer qindra projekte humanitare në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, në të gjitha pjesët e saj, pa dallime etnike dhe fetare". Ai premtoi se edhe në të ardhmen FSK-ja do të vazhdojë realizimin e projekteve të këtilla, kudo që kanë nevojë qytetarët e Kosovës.

FSK-ja angazhohet në aksionin " Ta pastrojmë Kosovën"



Më 24 maj 2014 FSK-ja mori pjesë në aksionin në nivel vendi "Ta pastrojmë Kosovën", të organizuar nga OJQ-të dhe të përkrahur edhe nga institucionet shtetërore. Në këtë aksion FSK-ja angazhoi 250 pjesëtarë dhe njësi të saj në shkallë të gjerë si dhe 50 automjete teknike në 30 komuna të Kosovës. FSK-ja ka angazhuar edhe zhytës për pastrimin e thellësive të liqenit të Batllavës nga mbeturinat e sjella nga reshjet. Për të ndihmuar aksionin dhe mbarëvajtjen e tij FSK-ja kishte në gjendje gatishmërie edhe njësinë e deminimit, mjekësisë, etj.

FSK-ja shënon Ditën Ndërkombëtare të Tokës

Ditën Ndërkombëtare të Tokës, 22 Prillin, FSK-ja e shënoi me aktivitete të ndryshme në hapësirat e kazermave të FSK-së, me mbjelljen e drunjve dekorativë, pishave dhe luleve. Aktiviteti kryesor u mbajt në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, ku morën pjesë: komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministri Bejtush Gashi, komandanti i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli si dhe ushtarë dhe oficerë të FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pasi mbolli fidanin e parë tha:"Kujdesi për mjedisin është përgjegjësi e jona e përbashkët, andaj duhet të jemi aktiv në mbrojtjen e tij, jo vetëm në kazerma, por edhe në ambientet e përgjithshme".



“8 Marsi shënohet në MFSK dhe FSK”

Gratë në MFSK dhe FSK shënuan 8 Marsin - Ditën e Gruas duke vizituar Prekazin për të nderuar sakrificën sublime të heronjve të rënë.
Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës organizuan, në kazermën “Adem Jashari” të Komandës së Forcave Tokësore, një takim me të gjitha gratë që shërbejnë në Ministri dhe FSK. Në këtë takim morën pjesë: ministri i FSK-së, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFOR-it, gjenerali Salvatore Farina, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, përfaqësuesja e organizatës joqeveritare “Rrjeti i grave” Igballe Rugova, deputetja Ganimete Musliu, anëtare e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.
Ministri Çeku në urimin e tij dedikuar këtij rasti tha: “Femrat që punojnë në Ministri dhe Forcë janë shumë aktive, të devotshme dhe vazhdimisht kanë dhënë rezultate në punë dhe shërbim. Ne jemi krenar që si vend po aspirojmë integrimin euroatlantik dhe i tërë zhvillimi i institucionit tonë po bëhet në përputhje me këto standarde”.



Certifikohen kadetë në Kursin e Avancuar për Lider Luftarak

Në kazermën “Skënderbeu” në Ferizaj, më 28 shkurt 2014, janë certifikuar 28 pjesëtarë të FSK-së, të cilët kanë kryer një trajnim intensiv për Lider të Avancuar Luftarak, gjenerata e parë, për vitin 2014.
Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, tha: “Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim i kemi kushtuar zhvillimit të trupës së nënoficerëve dhe ky zhvillim po ndodhë në mënyrën më të mirë të mundshme. Qëllimi i realizimit të kursit të avancuar për lider luftarak është arritja e vlerave teknike dhe taktike të udhëheqësit, atributet, aftësitë dhe veprimet e nevojshme për të

Femrat përfaqësuese të institucioneve të sigurisë pjesë e një tryeze pune në MFSK



Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MFSK, më 13 shkurt 2014, organizuan një takim zyrtar me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e sigurisë të femrave që shërbejnë në uniformë në kuadër të institucioneve të sigurisë të Kosovës. Në këtë takim, mori pjesë ministri i MFSK-së Agim Çeku dhe sekretari i përgjithshëm i MFSK-së Shkëlzen Sylaj. Ministri Çeku, me këtë rast, çmoi lart kontributin e femrave në FSK duke cekur faktin se përqindja e pjesëmarrjes së tyre është më kënaqshme se në disa vende të NATO-s. “Femrat në FSK janë duke luajtur rol të jashtëzakonshëm në afirmimin e FSK-së si forcë gjithëpërfshirëse dhe si forcë që po ngrihet dhe ndërtohet me standardet e NATO-s. Në këtë takim major Remzie Zeqiraj, oficere për Marrëdhënie me Publikun prezantoi temën “Kontributi dhe perspektiva e femrave në MFSK”, kurse Halime Morina, shefe e Njësisë për të Drejtat e Njeriut, prezantoi temën “Perspektiva Gjinore në MFSK dhe FSK”.

Seminari me temë “Përparimi i integrimit të komuniteteve në FSK”

Zyra për Komunitete në MFSK, më 09 korrik 2014, mbajti seminarin me temë “Përparimi i integrimit të komuniteteve në FSK”. Para drejtuesve të lartë të MFKS/FSK-së, ambasadorëve, zëvendës ambasadorëve, atasheve ushtarakë të akreditуar në vendin tonë. Fjalën tematike e mbajti Azemina Çullum, drejtoreshë e Zyrës për Komunitete në MFSK. Zonja Çullum, me këtë rast ajo tha: “Numri i pjesëtarëve të komuniteteve në FSK ka arritur një progres të madh, ku nga 6 pjesëtarë sa ishin në vitin 2009, tash ka arritur në 200 pjesëtarë të të gjitha komuniteteve të cilët kanë grada dhe pozita të ndryshme në FSK, si oficerë, nënoficerë dhe ushtarë”. Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, para të pranishmëve foli për gjendjen, zhvillimet, sukseset si dhe sfidat e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai tha se angazhimi i FSK-së për të realizuar objektivin për të qenë një forcë e dukshme dhe pranë qytetarëve të Kosovës e sidomos komuniteteve pakicë, duke i përkrahur dhe mbështetur në projekte të ndryshme infrastrukturore dhe humanitare, e ka bërë FSK-në një forcë të besueshme për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. “Ky imazh ka kontribuar në fushatat tona të suksesshme rekrutuese, ku në secilën fushatë kemi pasur shumë të rinjtë nga komunitetet pakicë të interesuar për t'iu bashkangjitur FSK-së”. Gjeneral Kastrati theksoi faktin e shkollimit aktual të disa kadetëve (të komuniteteve) në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë.





Ndeshje futbolli në mes ekipit përfaqësues të FA të Shqipërisë dhe përfaqësueses së FSK-së

Në stadiumin "Qemajl Stafa" në Tiranë, në kuadër të bashkëpunimit në mes FA të Republikës së Shqipërisë dhe FSK-së, u zhvillua loja miqësore në futboll të madh në mes të ekipeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe atij të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Loja u përcoll nga: ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneral brigade Enver Cikaqi, ambasadori dhe atasheu i Republikës së Kosovës në Shqipëri, z. Ramiz Lladrovci, nënkolonel Enver Dugolli, ushtarakë dhe oficerë të FA të Shqipërisë dhe përfaqësues të Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe nga mjaft sportdashës të kryeqytetit.

Të gatshme për mision të ri



Ky vit është viti i progresit të konsiderueshëm dhe edicioni special i "Forca Jonë" tregon sa shumë kemi arritur së bashku. Ne jemi krenar për atë së çfarë kemi bërë dhe jemi të gatshëm për të gjitha sfidat e së ardhmes në rrugën drejtë zhvillimit të mëtutjeshëm.

Dëshiroj të shpreh falënderimin tim të sinqertë të gjithë pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) të cilët kanë punuar me shumë zell për ta zhvilluar dhe fuqizuar forcën tonë. Puna e juaj me përkushtim vlerësohet lartë nga komandantët e juaj dhe nga qytetarët e vendit tonë.

Siç e dini, këtë pranverë Qeveria e ka përmbyllur Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Konkluzioni nga ky rishikim është që FSK-ja të transformohet në Forcat e Armatosura të Kosovës dhe që Kosova gradualisht duhet të marr përgjegjësitë e plota për sigurinë e saj.

Jam plotësisht i bindur që FSK-ja është gati të marrë këtë mision të ri. FSK-ja është gati të bëhet forcë e cila i mbron interesat e sigurisë së Kosovës dhe kontribuon në sigurinë regjionale, evropiane dhe ndërkombëtare. Kjo është një detyrë shumë fisnike dhe jemi plotësisht të vetëdijshëm që do të kërkoj nga secili prej nesh shumë përkushtim, kujdes dhe besnikëri.

Ëndrra dhe dëshira jonë më e madhe është të bëhemi pjesë e familjes Euro-Atlantike. Ne dëshirojmë ta zëmë vendin tonë në Institucionet Euro-Atlantike dhe të kontribuojmë për një botë më e mirë ku secili ndihet i sigurt. Ne e ndajmë vizionin e NATO-së për Evropën, vendet dhe popujt e të cilëve janë në paqe me njëri-tjetrin dhe me fqinjët e tyre. Ky është synimi ynë strategjik dhe së bashku do ta bëjmë maksimumin tonë që ta arrijmë atë.

Urime Ditën e Forcës të gjithëve!

Agim Çeku,
Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës











FORCA JONË

* * * Viti III • Nr. 31 • Dhjetor 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Të gatshëm për mision të ri!

Ky vit është vit i progresit të konsiderueshëm dhe edicioni special "Forca Jonë" tregon sa shumë kemi arritur së bashku. Ne jemi krenarë për atë se çfarë kemi bërë dhe jemi të gatshëm për të gjitha sfidat e së ardhmes në rrugën drejtë zhvillimit të mëtutjeshëm.

Dëshiroj të shpreh falënderimin tim të sinqertë të gjithë pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), të cilët kanë punuar me shumë zell për ta zhvilluar dhe fuqizuar Forcën tonë. Puna e juaj me përkushtim vlerësohet lart nga komandantët e juaj dhe nga qytetarët e vendit tonë.

Siç e dini, këtë pranverë Qeveria e ka përmbyllur Rishikimin e Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Konkluzioni nga ky rishikim është që FSK-ja të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës



dhe që Kosova gradualisht duhet të marr përgjegjësi të plota për sigurinë e saj.

Jam plotësisht i bindur që FSK-ja është gati të marrë këtë mision të ri. FSK-ja është gati të bëhet forcë e cila i mbron interesat e sigurisë së Kosovës dhe kontribuon në sigurinë regjionale, evropiane dhe ndërkombëtare. Kjo është detyrë shumë fisnike dhe jemi plotësisht të vetëdijshëm që do të kërkojë nga secili prej nesh shumë përkushtim, kujdes dhe besnikëri. Ëndrra dhe dëshira jonë më e madhe është të bëhemi pjesë e familjes Euro-Atlantike.

Ne dëshirojmë ta zëmë vendin tonë në Institucionet Euro-Atlantike dhe të kontribuojmë për një botë më të mirë ku secili ndihet i sigurt. Ne e ndajmë vizionin e NATO-s për Evropën, vendet dhe popujt e të cilëve janë në paqe me njëri-tjetrin dhe me fqinjët e tyre. Ky është synimi ynë strategjik dhe së bashku do ta bëjmë maksimumin tonë që ta arrijmë atë.

Agim Çeku,
Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës



FSK-ja shënoi Ditën e Forcës me ceremoni ushtarake

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, me një manifestim solemn të mbajtur në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, shënoi Ditën e Forcës, ditën e themelimit të saj dhe përuroi ndërtesën e re të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ceremonia për shënimin e Ditës së Forcës filloi me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të FSK-së nga presidentja Atifete Jahjaga dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati.

Thellohet bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Agim Çeku, së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastratin dhe sekretarin e përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj, me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë, më 6-7 nëntor qëndruan për një vizitë zyrtare në Republikën e Letonisë. Delegacioni i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës u prit në Riga nga ministri i Mbrojtjes së Letonisë, z. Raimonds Vejonis dhe stafi i lartë i kësaj ministrie.

Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes të Letonisë kanë marrëveshje bashkëpunimi, dhe kjo vizitë po zhvillohet me qëllim të thellimit të këtij bashkëpunimi. Ministri i Letonisë i konfirmoi ministrit Çeku gatishmërinë e tij për mbështetjen në zhvillimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe vazhdimin e bashkëpunimit dypalësh në mes dy ministrive.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku, me këtë rast, falënderoi ministrin e Mbrojtjes si dhe Qeverinë e Letonisë për mbështetjen e pakursyer për zhvillimin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, që është thelbësore për Kosovën. Ministri i Mbrojtjes së Letonisë, z. Raimonds Vejonis, gjatë takimit, i premtoi ministrit Çeku ndihmën dhe mbështetjen e tij për FSK-në dhe Kosovën në integrimet evropiane dhe euro-atlantike."Letonia i mbështet aspiratat euro-atlantike të Kosovës dhe është e gatshme të ndajë me të përvojën e saj në lidhje me procesin e integrimit



në NATO. Unë jam shumë i kënaqur me bashkëpunim e mirë në mes të Letonisë dhe MFSK-së. Letonia është gjithashtu e gatshme ta ndihmoi Kosovën në zhvillimin e forcave të saj të armatosura në të ardhmen". Ndërsa, ministri i MFSK-së, z. Agim Ceku, u shpreh falënderues për ndihmën e Letonisë. Unë jam shumë mirënjohës për ndihmën e vazhdueshme të Letonisë për Kosovën, aq më tepër jam mirënjohës dhe e vlerësoj faktin se Letonia është njëra ndër vendet e para që ka njohur pavarësinë e Kosovës. Ne i jemi mirënjohës edhe Ministrisë së Mbrojtjes të Letonisë e cila ka kontribuar dhe po vazhdon të kontribuojë me angazhimin e ekspertëve të saj profesional në Ekipin Këshillues të NATO-s.

Ministri Çeku e informoi homologun e tij edhe për planet e Kosovës, për ngritjen e forcave të saj të armatosura, dhe theksoi se Kosova dëshiron t'i bëjë këto zhvillime me mbështetjen e NATO-s. Delegacioni i MFSK-së, më pas, vazhdoi vizitën e tij në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kombëtare të Letonisë dhe në Bazën Ushtarake në Adazhi.



MFSK-ja në Ditën e Forcës përuroi objektin e ri

Në pjesën e dytë të programit për shënimin e Ditës së Forcës, me ceremoni ushtarake u bë përurimi i objektit të ri të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Në fjalën e tij, ministri Çeku përshëndeti presidenten, kryeministrin, ambasadorët, gjeneralët, oficerët dhe nënoficerët, si dhe të gjithë të pranishmit në përurimin e objektit të ri, si dhe Ministrinë e Administratës Publike e cila ka qenë përgjegjëse për realizimin e projektit dhe menaxhimin e punëve të ndërtimit. Ministri Çeku, me këtë rast, tha: "Sot po e shënojmë një ngjarje shumë të rëndësishme e cila është e veçantë për gjithë ne. Jemi të gëzuar pasi që kemi punuar më shumë se 15 vite, në kushte jo edhe aq të volitshme, ndërsa tani na janë ofruar kushte të shkëlqyeshme për punë, hapësira të mjaftueshme dhe moderne. Duke ju drejtuar kolegëve të punës, ministri Çeku tha: "Të nderuar kolegë, jam i sigurt që ju do të ndiheni mirë duke punuar në këtë ndërtesë. Për më shumë, duke pasur një ndërtesë moderne, ju do të keni më shumë mundësi të përqendroheni më lehtë në detyrat e juaja dhe do t'i kryeni ato me ma shumë sukses.

Ndërsa, në emër të Ministrisë së Administratës Publike foli zëvendës ministri Fadil Kryeziu, i cili me këtë rast, tha: Ky objekt i MFSK-së i plotëson të gjitha kriteret dhe standardet sipas kërkesave të NATO-s. Objekti ka një sipërfaqe prej 100.00 metrave katrorë dhe ka kushtuar mbi 5.700.000 euro buxhetit të shtetit. Në fund, shiritin e përurimit të objektit e prenë ministri Agim Çeku dhe zëvendës ministri Fadil Kryeziu.

F'jala e KOMF'SK-së me rastin e Ditës së Forcës

FSK-ja e gatshme për detyra të reja

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) po e feston përvjetorin e saj të gjashtë. Kjo ditë, tashmë tradicionale, na bashkon të gjithëve për të festuar dhe reflektuar njëkohësisht.

Forca jonë në themelet e saj ka të skalitur lavdinë dhe përvojën e trashëguar brez pas brezi. FSK-ja si forcë profesionale, shumetnike dhe e motivuar, është institucioni më i besueshëm i vendit. Ky fakt na gëzon e na bënë krenarë, e njëkohësisht na obligonë edhe më tepër për të punuar fortë në ruajtjen e imazhit dhe besueshmërisë.

Sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat kemi kaluar dhe ato që na presin, janë sprova që do të kalohen falë vullnetit dhe përkushtimit tonë të fortë.

Forca jonë përbëhet nga pjesëtarë të motivuar, të përkushtuar e të brumosur me virtytet më të larta. Përkushtimi, gatishmëria, guximi, profesionalizmi, virtytet dhe vlerat më sublime të mishëruara tek pjesëtarët tonë, na bëjnë t'u gëzohemi arritjeve të deritanishme dhe na japin fuqi e besim për t'i kaluar edhe sfidat e së ardhmes.

Kjo ditë e veçantë është një moment shumë i përshtatshëm për të shprehur mirënjohjen më të sinqertë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, të cilët po bartin në supet e tyre peshën e ngritjes dhe zhvillimit të FSK-së në një Forcë moderne dhe profesionale. Pjesëtarët e FSK-së, gjithmonë, janë të gatshëm për t'i kryer detyrat. Nënoficerët e përgatitur dhe të motivuar, për të qenë gjithnjë krahë për krahë me ushtarët dhe oficerët që udhëheqin me shembullin personal, janë boshti dhe imazhi i Forcës tonë me të cilën të gjithë krenohemi sot.

Arritjet e FSK-së janë të prekshme, kualitative dhe gjithsesi të pritura. FSK-ja gjatë gjithë këtyre viteve ka ngritur kapacitete operacionale për realizimin e misionit të sajë në bazë të mandatit kushtetues. Ka ngritur standarde të realizimit të detyrave, duke shfaqur gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së detyrave. FSK-ja vazhdon të kryejë operacione dhe intervenime të rëndësisë qenësore për qytetarët e vendit, siç janë: operacionet e deminimit; operacionet e kërkim-shpëtimit në ujëra, male dhe zona urbane; reagimi i shpejtë i bashkërenduar me institucionet tjera në rast të krizave; angazhimi në shumë projekte humanitare në përkrahje të qytetarëve, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, si dhe komuniteteve anë e kënd Kosovës; asistenca mjekësore në përkrahje të banorëve nga radhët e komuniteteve nëpër zonat e thella.

F'SK-ja është në proces të vazhdueshëm të ndërtimit të kapaciteteve, duke e themeluar Task Forcën e Kërkim- Shpëtimit dhe duke i plotësuar kriteret e vendosura për t'u certifikuar nga Grupi Këshillues i Kërkim-Shpëtimit Ndërkombëtar, gjë që



shënon bashkëpunimin e suksesshëm në mes nesh dhe partnerëve tanë.

Këtë vit, FSK-ja ka marrë pjesë në një varg ushtrime fushore dhe kurse trajnuese, të cilat synojnë thëllimin e bashkëpunimit në mes shteteve të rajonit gjatë reagimit në kriza dhe situata të menaxhimit të krizave. Pjesëtarët e FSK-së kanë dëshmuar që FSK-ja është forcë për të mirë dhe e aftë, gjithmonë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe e gatshme të kontribuojë në sigurinë rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Në zhvillimin tonë të mëtutjeshëm, ne bashkëpunojmë ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë të cilëve ju jemi mirënjohës për mbështetjen e tyre, këshillat dhe ekspertizën. Ne e falënderojmë NATO-n për mbështetjen e vazhdueshme përmes NLAT-it dhe NAT-it.

Ndihemi të bekuar dhe krenarë për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe partneritetin me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Si komandat i FSK-së, me siguri të plotë, ritheksoj që FSK-ja është e gatshme të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës dhe të marr DETYRAT E REJA - mbrojtjen e vendit dhe qytetarëve të saj. Kjo është një detyrë shumë fisnike dhe jemi plotësisht të përkushtuar ndaj saj.

Në këtë ditë të rëndësishme dua që solemnisht të ua uroj Ditën e Forcës, të gjithë efektivave të FSK-së, të gjithë ushtarëve aktiv dhe rezervë, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës uron komandantin e FSK-së për Ditën e Forcës



Gjenerallejtënant Kadri Kastrati
Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës
I nderuari Gjeneral Kastrati

Me mburrje të madhe dëshiroj të ju shkruaj urimet për ju dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës për kremtimin vjetor të Ditës së Forcës të Kosovës.

Qëllimi i një dite që njeh dhe nderon Forcën e Sigurisë së Kosovës është një ngjarje e rëndësishme që simbolizon një hap të rëndësishëm në suksesin e vazhdueshëm të Forcës tuaj të Sigurisë.

Programi ynë i Partneritetit me Forcën e Sigurisë së Kosovës të Republikës së Kosovës është një nga marrëdhëniet tona më të rëndësishme dhe më të qëndrueshme.

Jemi krenar që mbështesim Kosovën dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës si partner i saj.

Vazhdojmë të fuqizojmë partneritetin tonë përmes mundësive të shkëmbimit në Ajova dhe po ashtu në Kosovë.

Ju dhe të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të jeni shumë krenarë me këtë.

Sërish, urimet e mia më të mira dhe të sinqerta në këtë ditë të rëndësishme.

Jam i sigurt që Forca e Sigurisë së Kosovës do të vazhdojë të jetë një forcë për të mirën e të gjithëve në Kosovë, me një prezencë të qëndrueshme në regjionin e Ballkanit.

Mezi presim të vazhdojmë me shumë angazhime në të ardhmen, ashtu siç do tëvazhdojmë ta fuqizojmë miqësinë tonë.

Kjo me të vërtetë është diçka për të cilën duhet të jemi krenar.

Sinqerisht,
Timothy E. Orr
Gjeneralmajor, Garda Kombëtare e Ajovës

Shefi i Shtabit të Përgjithsëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë uron Komandantin e FSK-së për Ditën e Forcës



I nderuari Gjeneral Kastrati!

Me rastin e krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës është kënaqësi dhe privilegj që në emrin tim personal por edhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, t'ju përcjell urimet më të sinqerta e të përzemërta.

Forca e Sigurisë së Kosovës, me shërbimin e saj ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, ka arritur të krijojë besim dhe krenari brenda vendit, ndërkohë gëzon mbështetje ndërkombëtare gjithnjë e në rritje.Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë e vlerësojnë jashtëzakonisht shumë rolin dhe kontributin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në drejtim të forcimit të stabilitetit në rajon. FARSH do të vijojë mbështetjen për FSK për integrim sa më të shpejtë në struktura ushtarake të sigurisë, si dhe do të forcojë bashkëpunimin dypalësh në fusha të ndryshme ushtarake.Duke ju shprehur konsideratat e mia më të larta, më lejoni që edhe njëherë, t'ju përcjell urimet e mia më të mira për ditën e krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Gjeneral Major Jeronim Bazo
Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kroate uron Gjeneral Kastratin për Ditën e Forcës



I nderuar Gjeneral Kastrati,

Më lejoni të ofroj urimet më të përzemërta të burrave dhe grave të Forcave të Armatosura Kroate dhe të miat për ty personalisht dhe pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Republikës së Kosovës me rastin e Ditës së Forcës së Sigurisë.Do të dëshiroja të nxjerr në pah faktin që marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Forcave tona të Armatosura janë duke u zhvilluar shumë me sukses. Shpresoj që në drejtim të punës tone të ardhshme, ne do të vazhdojmë të zhvillojmë dhe thellojmë tiparet dhe opsionet e ndryshme të bashkëpunimit ushtarak dypalësh duke i'u përgjigjur parimeve të profesionalizmit dhe partneritetit, në kontributin e përbashkët të ruajtjes së paqës, sigurisë dhe stabilitetit në rajonin tonë. I nderuar Gjeneral, edhe njëherë, pranoni përgëzimet e mia të sinqerta për Ditë e Forcës të Sigurisë. Ju dëshiroj shëndet të mirë dhe sukses si në jetën personale ashtu edhe profesionale për ju, gjithashtu edhe për të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Sinqerisht,
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kroate Gjeneral
Drago Lovric, Ph.D.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjeneralmajor Rrahman Rama në ceremoninë e ndërrimit të Komandës së Ushtrisë së SHBA-ve për Evropë

Zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandant i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneralmajor Rrahman Rama i shoqëruar edhe nga major Beton Retkoceri dhe rreshter major Fetah Zejnullahu, më 06 nëntor 2014, mori pjesë në ceremoninë e organizuar të ndërrimit të Komandës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara për Evropë (USAREUR) të mbajtur në Wiesbaden të Gjermanisë. Këtë detyrë, deri më tani e ka kryer gjenerallejtënant Donald M. Campbell, ndërsa në vend të tij, detyrën e komandës së USAREUR do ta kryejë gjenerallejtënant Frederick B. Hodges.



Gjeneralmajor Rrahman Rama, me këtë rast, i uroi gjenerallejtënant Frederick Hodges detyrën e re dhe njëherësh e falënderoi USAREUR-in për ndihmën që ata po japin në vazhdimësi për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Instruktorë të Gardës Kombëtare të Ajovës mbajtën seminarin "Menaxhimi i ciklit jetësor dhe funksionimi i bordeve"



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), nga data 17deri më 21 nëntor 2014, u mbajt seminari "Menaxhimi i ciklit jetësor dhe funksionimi i bordeve", nga instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës të udhëhequr nga rreshter majori David Carstens. Qëllimi i seminari ishte bashkërendimi i veprimeve për përmirësimin e menaxhimit të karrierës dhe ngritjen e autoritetit dhe ndikimin e nënoficerëve në përgjithësi. Seminarin e ndoqën 35 nënoficerë të FSK-së, me një përbërje të kombinuar nga stafi dhe komanda. Pjesëmarrësit gjatë seminarit i vizitoi edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, i cili falënderoi ekipin e instruktorëve të Gardës Kombëtare të Ajovës për kontributin e dhënë në avancimin dhe ngritjen profesionale të FSK-së. Ai gjithashtu u shpreh i gatshëm për t'i përkrahur rekomandimet e këtij seminari dhe projektet tjera të ardhshme. Gjeneral Kastrati me këtë rast ndau mirënjohje për instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës. Rreshter majori i Gardës Kombëtare të Ajovës, David Carstens, në fjalën e tij përmbyllëse, foli për rëndësinë e këtij seminari dhe për përkushtimin e Gardës Kombëtare të Ajovës për të përkrahur FSK-në në ngritjen profesionale të saj për t'i quar proceset përpara. Ekipin e instruktorëve nga Ajova, për punën e tyre vetëmohuese, e falënderoi Rreshter majori i Komandës së FSK-së Genc Metaj, i cili i përgëzoi edhe pjesëtarët e FSK-së për përkushtimin e tyre dhe pjesëmarrjen aktive në punimet e seminarit "Menaxhimi i ciklit jetësor dhe funksionimi i bordeve".

Bashkëpunim i ngushtë në fushën e mjekësisë ndërmjet MFSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë

Kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, shef i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i shoqëruar nga nënkolonel Bekim Osmani, atashe ushtarak i Kosovës, pranë Ambasadës së Republikës së Kosovës në Ankara dhe major dr. Genc Shala, zëvendëskomandant i Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së, nga data 3 deri me 5 nëntor 2014, qëndruan për vizitë zyrtare në Akademinë ushtarake mjekësore "GATA" në Ankara të Republikës së Turqisë. Kolonel dr. Tahiraj dhe oficerët e lartë të FSK-së u pritën nga dekani i Akademisë ushtarake mjekësore, kundëradmirali Hayati Bilgiq. Gjatë takimit të përbashkët u diskutuan çështje të bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ndërmjet dy institucioneve, si dhe thellimi dhe vazhdimi i këtij bashkëpunimit edhe në të ardhmen.



Kundëradmirali Bilgiq premtoi angazhim në drejtim të implementimit të protokollit të bashkëpunimit ndërmjet të dyja institucioneve tona. Gjatë qëndrimit në Ankara, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj me bashkëpunëtorë vizituan edhe Fakultetin e Mjekësisë, Akademinë e Nënoficerëve Mjekësorë, Akademinë e Infermierisë si dhe Qendrën e Rehabilitimit. Gjithashtu oficerët e FSK-së vizituan edhe nënoficerin e FSK-së (A.M), i cili po trajtohet në këtë qendër. Vizita e kolonel dr. Tahiraj, shef i Departamentit Mjekësor në Ministrinë e FSK-së në Akademinë ushtarake mjekësore "GATA" të Republikës së Turqisë, u zhvillua në kuadër të protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë i nënshkruar në prill të këtij viti.

Zëvendësambasadorja e Mbretërisë së Bashkuar vizitoi FSK-në

Ditë më parë, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe në FSK, për një vizitë zyrtare ishte zëvendës ambasadorja e Mbretërisë së Bashkuar, znj. Louise Taylor me bashkëpunëtorë. Zëvendës ambasadoren Taylor e priti ministri i MFSK-së z. Agim Çeku, i cili e falënderoi për ndihmën e vazhdueshme që Mbretëria e Bashkuar po jep për FSK-në, si dhe e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Po ashtu edhe znj.Louise Taylor e falënderoi ministrin Çeku për pritjen dhe njëherësh premtoi vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Më pas ajo vizitoi edhe Qendrën për Studime Universitare (QSU) të FSK-së, ku për shkollimin dhe të arriturat e përgjithshme të kësaj qendre e njoftoi kapiteni Avni Kiqina, komandant i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së.



Gjeneral Kastrati priti një delegacion të mjekësisë ushtarake nga Mbretëria e Bashkuar



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, priti nënkolonel Mike Connolly nga Qendra e Zhvillimit të Koncepteve dhe Doktrinave të Mbretërisë së Bashkuar me bashkëpunëtorë. Nënkoloneli Mike Cannolly e njoftoi komandantin e FSK-së, gjeneral Kastratin, për punën e deritanishme të përbashkët me Departamentin e Mjekësisë të FSK-së, në hartimin e dokumenteve dhe doktrinave ushtarake mjekësore. Komandanti i FSK-së e falënderoi nënkolonel Cannolly për bashkëpunimin me Departamentin e Mjekësisë të FSK-së, për angazhimin dhe punën e palodhshme që ata po bëjnë në hartimin e doktrinave ushtarake për mjekësi. Në takim mori pjesë edhe drejtori i Departamenti të Mjekësisë të MFSK-së, kolonel Xhevdet Tahiri dhe këshilltari i komandantit të FSK-së, nënkolonel David Jons.

Komandanti i BRSH-së vizitoi Muzeun Arkeologjik në Istog



Komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Nazmi Brahimaj me bashkëpunëtorë, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional,më 5 tetor 2014, vizituan Muzeun Arkeologjik të Komunës së Istogut. Delegacionin e BRSH-së e priti z. Enver Boletini, përgjegjës për trashëgimi kulturo-historike në Komunën e Istogut, i cili me këtë rast e njoftoi komandantin e BRSH-së për historikun e muzeut, artefaktet që ka ky muze të cilat pasqyrojnë lashtësinë e trevës së Podgurit. Në muze janë të ekspozuara monumente dhe artefakte të periudhave të ndryshme që nga lashtësia e deri në periudhat e vonshme të historisë së Kombit tonë e që përbëjnë vlera të trashëgimisë së Podgurit: Etnologji, arkeologji të karakterit fetar, kulla, mullinj me ujë, trashëgimi natyrore etj. Gjeneral Brahimaj falënderoi zyrtarët e Muzeut Arkeologjik për pritjen dhe mundësinë qe ata iu ofruan gjatë vizitës për t'u njohur nga afër me trashëgimin historike të këtij muzeu. Në fund të vizitës, të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi në mes dy institucioneve të vazhdojë edhe në të ardhmen, në funksion të mbrojtjes së trashëgimisë kulturo-historike të kësaj treve.

FSK-ja shënoi Ditën e Forcës me ceremoni ushtarake

Homazhe në Prekaz: Manifestimi i "Ditës së Forcës", 27 Nëntori, filloi me homazhe në "Kompleksin Memorial" në Prekaz. Ministri Agim Çeku, ishte pjesë e delegacionit të Qeverisë së Kosovës të prirë nga kryeministri Hashim Thaçi, ndërsa delegacioni i FSK-së udhëhiqej nga komandanti i saj, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Të dy delegacionet vendosen kurora me lule dhe bënë homazhe në varrin e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe në varrezat e Jasharajve.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, me një manifestim solemn të mbajtur në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, shënoi Ditën e Forcës, ditën e themelimit të saj dhe përuroi ndërtesën e re të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ceremonia për shënimin e Ditës së Forcës filloi me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të FSK-së nga presidentja Atifete Jahjaga dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Ndërsa, në shenjë nderimi për të gjithë të rënët për Lirinë e Kosovës u mbajt një minutë heshtje.



Nga fjala e presidentës së Kosovës, Atifete Jahjaga

Në rrugëtimin e saj FSK-ja ka pasur mbështetjen e NATO-s



Fjalën kryesore e mbajti Presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, e cila fillimisht uroi FSK-në për ditën e saj: "Dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për ju, gjeneralë e udhëheqës të FSK-së. Forca e Sigurisë së Kosovës është e ndërtuar mbi themele të fuqishme, që udhëhiqet nga synimi për të krijuar infrastrukturë të plotë të sigurisë në përputhje me nevojat e shtetit tonë dhe në harmoni me interesat tona kombëtare për të qenë faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë.

Në rrugëtimin e saj, FSK-ja ka pasur mbështetjen e NATO-s dhe forcës së saj paqeruajtëse në Kosovë, si dhe të Gardës Kombëtare Amerikane.

Me përmbylljen e procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë - një proces gjithëpërfshirës dhe ndërinstitucional - që analizoi mekanizmat tonë të sigurisë, nevojat e qytetarëve të Kosovës dhe interesat e orientimet strategjike të shtetit tonë- është shtruar nevoja e krijimit të një Force moderne të armatosur, me kapacitete mbrojtëse, që adreson sfidat e sigurisë, e kompleton infrastrukturën tonë të sigurisë dhe në proces e sipër të profesionalizimit me standarde të NATO-s, synon anëtarësimin e saj të plotë në këtë aleancë.

E ardhmja e Forcës së Armatosur të Kosovës, që nuk ka alternativë, mbetet punë parësore për Kuvendin e ri, institucionit kaq të nevojshëm dhe kaq të rëndësishëm për vendin dhe për qytetarët e tij, duke e bërë Kosovën me forcën e vet mbrojtëse, që do të kompletojë konsolidimin e shtetit tonë dhe do të bëhet kontribuuese e sigurisë kolektive të Evropës.

Nga fjala e kryeministrit të Kosovës

Transformimi i FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës ndër prioritetet e para



Ndërsa, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të pranishmit i përshëndeti kryeministri i saj, z. Hashim Thaçi, i cili, ndër të tjera, tha: "Më 21 janar mbushen 6 vjet që nga themelimi i njërit prej institucioneve më të rëndësishme dhe më prestigjioze të Republikës së Kosovës, Forcës së Sigurisë së Kosovës. Njëra ndër prioritetet e institucioneve që do të funksionalizohen së shpejti është edhe zotimi për t'i kaluar të gjitha procedurat juridike që FSK-ja të transformohet sa më shpejt në Forca të Armatosura të Kosovës. Jemi krenarë që FSK-ja, si institucion prestigjioz dhe profesional, sot funksionon në kapacitete të plota, e gatshme dhe e aftë për të përmbushur misionin e saj. FSK-ja, duke bashkëpunuar ngushtë me NATO-n dhe KFOR-in, sot është e gatshme që të kryejë të gjitha obligimet brenda në Kosovë, por edhe ato në rang të marrëveshjeve rajonale dhe shtetet përreth nesh. Të arriturat e FSK-së janë rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë dhe të frytshëm me Gardën Nacionale të Ajovës të SHBA-ve, me Ministritë Mbrojtjes të shteteve mike, si: Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Italisë, por edhe të Letonisë e Lituanisë dhe vendeve tjera.

Falë këtij bashkëpunimi kuadrot e FSK-së specializohen në kolegjet më të avancuara të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Kroacisë, Turqisë dhe vendeve tjera. Edhe me këtë rast këtyre shteteve u shprehim dhe i falënderojmë për ndihmën dhe përkrahjen e tyre.

FSK-ja është pjesë e iniciativave rajonale dhe përpjekjeve që të jetë e barabartë me shtetet anëtare të Kartës së Adriatikut. Ai, në fund, shtoi se: Perspektiva euroatlantike e FSK-së, do të jetë prioritet i qeverisë së re.









Medalje dhe dekorata për më të dalluarit për nder të Ditës së Forcës

Në fund të ceremonisë, për arritje të jashtëzakonshme u dekoruan ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të FSK-së.

Ministri dhe komandanti i FSK-së, me rastin e shënimit të "Ditës së Forcës", më 27 Nëntor 2014, me motivacionin për arritje të jashtëzakonshme ndanë medalje dhe dekorata për pjesëtarët e dalluar të Ministrisë dhe FSK-së:

Medalja "Shërbim i shquar", u jepet 21 pjesëtarëve të dalluar për shërbime të shquara në detyra me përgjegjësi të lartë, si dhe për realizimin e detyrave specifike dhe kontributin e shquar në reformimin, ristrukturimin dhe modernizimin e FSK-së.

Medalja "Arritje e jashtëzakonshme", u ndahet tre pjesëtarëve të FSK-së për arritje të jashtëzakonshme në zbatimin e detyrave, të gatishmërisë, stërvitjes, disiplinës dhe marrëdhënieve në aktivitete brenda dhe jashtë repartit.

Mirënjohja "Për angazhim dhe punë të dalluar" u ndahet 15 pjesëtarëve të FSK-së.

Medalja "Rezultate të larta në përvetësimin e programit mësimor", gjatë shkollimit në Kolegjin e Luftës në Turqi, i ndahet një pjesëtari të FSK-së.

Medalja "Shërbim vetëmohues", u ndahet 16 pjesëtarëve të MFSK-së dhe FSK-së me motivacionin performancë e dalluar gjatë kryerjes së detyrave.

Medalja "Komandanti", me motivacionin për kryerjen me sukses të detyrës së komandantit të Kompanisë dhe performancës së shkëlqyeshme gjatë shërbimit u ndahet 2 pjesëtarëve të FSK-së.



Për të arriturat e FSK-së, foli komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati.

FSK-ja forcë moderne, profesionale dhe gatshme për detyra të reja



Forca e Sigurisë së Kosovës po e feston përvjetorin e saj të gjashtë. Është viti i gjashtë që në "Ditën e Forcës" takohemi këtu në kazermën „Adem Jashari", në këtë kazermë që simbolizon shumëçka nga historia e lavdishme e Kosovës. Kjo ditë tashmë tradicionale na bashkon të gjithëve për të festuar dhe reflektuar njëkohësisht. Forca jonë, në themelet e saj ka të skalitur lavdinë dhe përvojën e trashëguar brez pas brezi. FSK-ja si forcë profesionale, shumetnike dhe e motivuar, është institucioni më i besueshëm i vendit. Ky fakt na gëzon e na bënë krenarë, e njëkohësisht na obligon edhe më tepër, për të punuar fortë në ruajtjen e imazhit dhe besueshmërisë. Sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat kemi kaluar dhe ato që na presin, janë sprova që do të kalohen falë vullnetit dhe përkushtimit tonë të fortë. FSK-ja ka shënuar përparim të vazhdueshëm në shumë fusha, një fakt ky që na bën krenar. Kjo ditë e veçantë është një moment shumë i përshtatshëm për të shprehur mirënjohjen më të sinqertë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, të cilët po bartin në supet e tyre peshën e ngritjes dhe zhvillimit të FSK-së, në një Forcë moderne dhe profesionale

Të nderuar të pranishëm,

Arritjet e FSK-së janë të prekshme, kualitative dhe gjithsesi të pritura. Padyshim, këto arritje janë rezultat i procesit të detajuar në përmbushjen e objektivave dhe prioriteteve të vendit, si dhe punës së zellshme të secilit prej Jush dhe përkushtimit për t'i arritur ato.

FSK-ja gjatë gjithë këtyre viteve ka ngritur kapacitete operacionale për realizimin e misionit të saj në bazë të mandatit kushtetues. Ka ngritur standarde të realizimit të detyrave, duke shfaqur gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm. Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdon të kryejë operacione dhe intervenime të rëndësisë qenësore për qytetarët e vendit, sikur: Operacionet e deminimit, Operacionet e kërkimshpëtimit në ujëra, male dhe zona urbane, siç ishte operacioni në liqenin e Ujmanit, Reagimi i Shpejtë i bashkërenduar me institucionet tjera në rast të krizave, siç ishte reagimi i në termocentralin „KOSOVA A", Projektet humanitare, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës së qytetarëve, Asistenca mjekësore nëpër zonat e thella rurale. Këtë vit, Forca e Sigurisë së Kosovës ka marrë pjesë në një varg të ushtrimeve fushore dhe kurseve trajnuese. Duke punuar krah për krah me ushtarët nga shtetet e rajonit, pjesëtarët e FSK-së kanë dëshmuar që FSK-ja është forcë për të mirë dhe e gatshme të kontribuojë në sigurinë rajonale dhe globale. Në zhvillimin tonë të mëtutjeshëm, ne bashkëpunojmë ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë të cilëve ju jemi mirënjohës për mbështetjen e tyre. Posaçërisht, e falënderojmë NATO-në për mbështetjen e vazhdueshme. Ndihemi të bekuar për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Gardën Kombëtare të Ajovës. Me përmbylljen e procesit - Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë është kolauduar që Forca e Sigurisë së Kosovës të transformohet në Forcë mbrojtëse të vendit. Unë si komandat i FSK-së, me siguri të plotë mund ta ritheksoj që Forca e Sigurisë së Kosovës është e gatshme të transformohet në Forcat e Armatosura të Kosovës dhe të merr DETYRAT E REJA - mbrojtjen e vendit dhe qytetarëve të saj. Kjo është një detyrë shumë fisnike dhe jemi plotësisht të përkushtuar ndaj saj.

Të nderuar të pranishëm,

Në këtë ditë të rëndësishme, solemnisht ua uroj Ditën e Forcës, të gjithë efektivave të FSK-së, të gjithë ushtarëve aktiv dhe rezervë, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së. Urime Ditën e Forcës gjeneralë dhe oficerë, ju që me profesionalizmin më të lartë po komandoni dhe drejtoni, po planifikoni dhe po përcillni realizimin e çdo detyre.Urime Ditën e Forcës ju nënoficerë, që me vetëmohim dhe vetë-iniciativë po bëni që çdo detyrë e dhënë të realizohet suksesshëm. Shumë urime të nderuar dhe të respektuar ushtarë të FSK-së, që me vetëbesim, vetëmohim, guxim e besnikëri, të gatshëm dhe me profesionalizëm po i shërbeni vendit tonë me nderë. Uroj dhe fuqishëm besoj se përvjetori i ardhshëm i FSK-së do ta gjej Forcën tonë edhe më të përgatitur, duke marrë mbi vete detyra dhe përgjegjësi të reja në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit.Urime Ditën e Forcës të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Ju që pandërprerë po përkrahni Forcën tonë me besim.

Urime të gjithëve dhe ju falemінderit!

Koloneli amerikan Chad Butts ligjëroi para oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së



Atasheu amerikan i Mbrojtjes kolonel Chad Butts i akredituar në Prishtinë, më 17 nëntor 2014, në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, për oficerët dhe nënoficerët mbajti një ligjëratë, për përvojën e tij gjatë karrierës ushtarake si pjesëtar i Forcave Ushtarake Ajrore të SHBA-ve, me shërbim në Honduras, Gjermani dhe në Turqi.

Ai kryesisht u ndal te procedurat standarde operative, respektimi i tyre, ndjeshmëria dhe pritjet, ishin këto disa nga temat në të cilat u fokusua koloneli Butts. Ligjërata ishte interaktive, ndërsa pjesëtarët e KDS-së i parashtruan pyetje të shumta si dhe dhanë komentet e tyre.

Koloneli Butts u prit nga shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Fadil Hadërgjonaj i cili e falënderoi për kontributin e tij dhe përmes tij, ambasadën amerikane që po e ndihmon në vazhdimësi FSK-në.

FSK-ja ndërtoi rrugën në fshatin Bozhec të Ranillugut



Në fshatin Bozhec të Komunës së Ranillugut, më 07 nëntor 2014, u bë përurimi i rrugës në gjatësi prej 2.5 km të ndërtuar nga Batalioni i Xhenios i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK)

Në këtë ceremoni morën pjesë: ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, eprorë të FSK-së, përfaqësues të komunës, banorë të fshatit dhe përfaqësues të KFOR-it suedez.

Me këtë rast, ministri i FSK-së, z.Agim Çeku, fillimisht i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së për punën që kanë bërë, për angazhimin dhe vullnetin e treguar gjatë këtij projekti. "Kjo rrugë ka një domethënie të madhe, ku dëshmon se FSK-ja po iu shërben të gjitha komuniteteve, të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kjo është një dëshmi se këta qytetarë kanë pasur kushte të vështira, ndërsa tani kanë kushte shumë më të mira, dhe është ndjenjë shumë e mirë për ushtarët të cilët janë në shërbim të vendit, kur kryejnë një punë të mirë dhe të gjithë të falënderojnë, duke pas parasysh se esenca e punës sonë është shërbimi pa dallim për të gjithë qytetarët e të gjitha bashkësive". Në emër të komunës foli drejtori i Shërbimeve Publike, Ivan Janiaijevic, i cili falënderoi Forcën e Sigurisë të Kosovës për punën e bërë, e në veçanti falënderoi pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të cilët punuan në këtë projekt. Ai më pastaj tha se ka qenë një bashkëpunim shumë i mirë i FSK-së me autoritetet e komunës dhe banorët e fshatit.

Ndërsa, shefi i Shtabit të Batalionit të Xhenios, major Ilmi Ramusholli, i informoi të pranishmit për punën e pjesëtarëve të Batalionit të Xhenios në realizimin e këtij projekti, rregullimin e rrugës së fshatit Bozhec. "Qëllimi i realizimit të këtij projekti ishte krijimi i kushteve sa më të mira për qarkullim i banorëve të këtij fshatit. Ky projekt ka filluar me 20 tetor dhe ka përfunduar më 07 nëntor 2014. Gjatë realizimit të këtij projekti është bërë hapja e kanalit anësor, nivelizimi, shtrirja e zhavorrit dhe trasimi i rrugës.

Brigada për Reagim të Shpejtë testoi gatishmërinë operacionale të njësive të saj në terren



Brigada për Reagim të Shpejtë, në kuadër të planit vjetor të ushtrimeve dhe aktiviteteve të Komandës së Forcave Tokësore, më 10-11 dhe 12 nëntor 2014, bëri testimin e gatishmërisë operacionale të njësive të saj në terren. Trajnimi kishte për qëllim testimin e gatishmërisë së këtyre njësive, në kryerjen e detyrave në kuadër të misionit të tyre, në ofrimin e mbështetjes autoriteteve të sigurisë dhe krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët. Komandën dhe Batalionin e Dytë të BRSH-së, gjatë ushtrimit, i vizituan: ministri i MFSK-së, z. Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rrahman Rama, të cilët për aktivitetet e BRSH-së, i njoftoi komandanti i saj, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, ndërsa majori Ejup Maqedonci, ushtrues i detyrës të shefit të Shtabit të BRSH-së, bëri një prezantimin të detajuar për skenarin dhe operacionet e njësive të BRSH-së në terren. Përveç testimit të personelit të BRSH-së për proceset e planifikimit, prioritet i saj ishte edhe testimi i njësive operacionale; operimi në terren me trupa. Testimi i njësive të BRSH-së, sipas skenarit, u realizua në dy lokacione, në Bjeshkët e Thata (Veri-Perëndim të Kosovës) dhe në Zhegoc (Jug-Lindje të Kosovës). Në fund, ministri Çeku, gjeneral Kastrati, gjeneral Rama dhe stafi i lartë i FSK-së, përcollën nga afër ushtrimet e njësive të Batalionit 2-të, të mbajtura në "Bjeshkët e Thata" të Istogut, të cilët vlerësuan lartë ushtrimin dhe profesionalizimin e treguar të njësive të BRSH-së në terren.

Batalioni i Parë i BRSH-së realizoi ushtrimin fushor "Shqiponja 3"

Batalioni i Parë i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Gjilan, realizoi ushtrimin fushor të koduar me emrin "Shqiponja 3". Ky ushtrim është realizuar në bazë të planit vjetor të aktiviteteve dhe trajnimeve në BRSH. Qëllimi i mbajtjes së ushtrimi fushor ishte testimi i gatishmërisë operacionale të njësive të BRSH-së. Sipas skenarit, nga pjesëtarët e Batalionit të Parë të BRSH-së, kërkohej ngritja e gatishmërisë në nivelin e tretë, që të jetë e gatshme që sipas urdhrit të operojë në zonën e operacionit, për të kryer operacione të sigurisë dhe shpëtimin e jetës. Në ushtrimin e mbajtur kryesisht në terrenet e fshatit Zhegoc, morën pjesë 288 pjesëtarë. Personeli i Kompanisë 1 C realizoi me sukses këto detyra si vëzhgimin dhe lëvizjen e trupave natën, ngritjen e post komandës, komunikim në pika të vdekura, infiltrim të personelit në radhët e armikut (opozitës), vij rrethim dhe kërkim, pastrim të objekteve, komunikim me autoritetet lokale dhe testim i përgatitjes fizike. Ushtrimin fushor të Batalionit të Parë e vizitoi edhe shef i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore kolonel Naim Haziri, të cilin për rrjedhën e ushtrimit në terren e njoftoi komandanti i Batalionit të Parë nënkolonel Haki Xhemajli.

Ndërsa kolonel Haziri i përgëzoi pjesëtarët e Batalionit të Parë të BRSH-së, për angazhimin, motivimin dhe profesionalizmin e treguar dhe njëherësh kërkoi vazhdimin e aktivitetet me trajnime specifike në të gjitha fushat e mundshme. Ushtrimi fushor i koduar me emrin "Shqiponja 3" përfundoi me sukses.



Major Genc Shala zëvendëskomandant i Kompanisë së Mjekësisë së FSK-së

Pjesëtarët e Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së me nivel të lartë profesionalizmi

Genc Shala është oficer i Kompanisë së Mjekësisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së) që nga viti 2009. Ai ka qenë edhe pjesëtar i TMK-së. Ai është specialist i mjekësisë interne. Studimet i ka përfunduar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Shenjat e para të dëshirës së tij për t'u bërë mjekë dhe për t'i kuruar njerëzit ishin që nga shkolla e mesme. Ai thotë që lënda e biologjisë e veçanërisht gjenetika e kishin bërë që të thellohej më shumë në studime për të kuptuar se si funksionon trupi i njeriut dhe kjo e kishte mahnitë atë tej mase. "T'i shohësh njerëzit si janë duke u shëruar për çdo ditë nga sëmundjet është më të vërtet ndjenjë shumë e mirë, dhe kur e kupton që t'i je personi që u ke ndihmuar në aspektin profesional, por edhe psikologjik. Çdo herë pjesëtarët e FSK-së si dhe familjarët e mi me pyesin në aspektin profesional për shqetësimet e tyre". Përveç punës që e bënë në FSK, major Shala është aktiv edhe atëherë kur e thërrasin në raste emergjente dhe ne intervenime të ndryshme në spital, madje ai tregon se ka pasur raste edhe në orët e vona kur ka intervenuar, sepse FSK-ja e ka edhe gatishmërinë 24 orë. I pyetur se cilat janë detyrat e tij si zëvendëskomandant i kompanisë së mjekësisë ai ndër të tjera përmendi planet e punës, trajnimet, dhe shumë aktivitete të përditshme, por edhe angazhimin e tyre në raste krizash. Kompania e Mjekësisë ka ekipin e mjekimit (trajnimit), ekipin e farmacisë, tri ekipe të evakuimit, ekipin e stomatologjisë, si dhe ekipin e IT-së. Kjo kompani është përgjegjëse për trajtimin e të gjithë pjesëtarëve që gjenden në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Po ashtu pjesëtarët e kësaj kompanie janë përgjegjës edhe në transferimin e pjesëtarëve në spitalin ushtarak të Tiranës. Genc Shala tregon që pjesëtarët e Kompanisë së Mjekësisë janë shumë të përgatitur profesionalisht



dhe kanë një disiplinë pikërisht ashtu siç i duhet ushtarakut. Ai këtë profesionalizëm e mbështet më fakte që gjatë ushtrimeve fushore të përbashkëta të mbajtura në Maqedoni dhe në Slloveni, pjesëtarët e FSK-së kishin treguar nivelin e njëjtë më ushtritë e rajonit, por edhe më gjerë. "Nga trajnimet që i kemi bërë dhe situatat me të cilat jemi përballur, konsideroj se jemi në nivel të njëjtë profesional me vendet e rajonit dhe vendet tjera". Përveç angazhimeve ditore, Genci përmend edhe trajnimet dhe ligjëratat e ndryshme që mbahen nga pjesëtarët e tij. Ai përmendi ligjëratën me personelin shëndetësor të Spitalit Rajonal të Prizrenit, për MASCAL (situatat me shumë lëndime). Rëndësi të veçantë po ashtu i kushtojnë edhe trajnimit për Ndihmën e Parë dhe certifikimi i pjesëtarëve pas përfundimit të këtij trajnimi dhe marrja e titullit si "Paramedik". Pastaj trajnimin e njëjtë që infermierët e Kosovës e kanë mbajtur në Kompaninë e Mjekësisë etj. Kemi shumë pjesëtarë jashtë vendit si: Gjermani, Turqi, Holandë, Shqipëri, Angli, SHBA, Maqedoni. "Nga Gjermania tanimë do kthehen dy pjesëtarë të cilët për dy vjet e kanë përfunduar shkollimin për teknik mjekësor, kurse në vendet tjera kryejnë shkollime kryesisht të fushës së mjekësisë por të fushave të ndryshme". Oficeri i lartë i FSK-së, major Genc Shala ka marrë pjesë edhe në trajnime në fushëbetejë: në Maqedoni "Shared Resilence", ku ka qenë edhe komandant i kontingjentit për FSK-në, dhe në Slloveni "Përgjigjeje e menjëhershme", si komandant i ekipit mjekësor dhe nga dy trajnime pjesëtarët e FSK-së kishin treguar rezultate shumë të mira profesionale dhe ushtarake. Ai ka të kryera edhe trajnime individuale si: Ndihma e parë, niveli I, në KDS, dhe niveli II, në Kompaninë e Mjekësisë, Ferizaj; Kursi Bazik moduli A(B); Shpëtimi i jetës në traumat e fushëbetejës, në Holandë; Sëmundjet infektive dhe tropikale, në Holandë, kursi për oficer, në KDS; seminar "Menaxhimi i katastrofave", në Prishtinë; trajnimin për instruktor të mjekësisë, në Bondesteel nga instruktorët e USA. Profesionalizmin individual dhe grupor major Shala e tregon edhe me intervenimet e shumta të pjesëtarëve të tij, sidomos, në vërshimet në Shqipëri gjatë viteve 2010-2011, intervenimin në Restelicë, ku pjesëtarët e kishin nxjerr të gjallë një vajzë 5 vjeçare " Më pëlqen rregulli, disiplina dhe puna me përkushtim qe e bëjnë të gjithë ushtarakët, "P.sh ka qenë rasti i Restelicës kur rreziku për të rënë edhe një ortek tjetër ishte ende. Asnjë nga pjesëtarët nuk ishin tërhequr nga vendi i ngjarjes, sepse ata dëshironin që të ndihmonin në shpëtimin e jetës së njerëzve atje, kjo më bënë që si pjesëtar i FSK-së të ndjehem krenar dhe i privilegjuar që jam pjesë e një ekip të tillë. I dua shumë ushtarët e mi dhe ata çdoherë janë të gatshëm për çdo situatë dhe detyrë që iu delegohet". Intervenimin e fundit në termocentralin Kosova A, ku po ashtu edhe në këtë operacion u nxjerr një djalë i gjallë, ishte gjithashtu dëshmi e suksesit të pjesëtarëve të FSK-së, e po ashtu edhe ekipit mjekësor. Në pyetjen se cili ka qenë momenti më i veçantë gjatë punës së tij si mjek në FSK, major Shala më shumë emocion përmend rastin kur pjesëtarët e Kërkim Shpëtimin e kishin nxjerr të gjallë vajzën 5 vjeçare Amsera Reka, i cili më pas e kishte dërguar në spitalin e Prizrenit. "Ndjenja më e mirë në jetën time ka qenë kur ma dhanë Amserën për ta dërguar në spitalin e Prizrenit dhe ngrohtësia që ndjeva ishte, edhe ajo që i kishte mbijetuar një fatkeqësie aq të madhe". Përveç punës si mjek në FSK ai kohen e lirë e shfrytëzon me aktivitete sportive, kujdesin për djalin e tij, një vjeç dhe duke e ndihmuar vajzën 8 vjeçare në mësime dhe zgjedhjen e detyrave të ndryshme.





Kadetë të Akademisë Ushtarake të Turqisë vizituan FSK-në



Në bazë të Planit Implementues në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, më 10 nëntor 2014, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës qëndroi një delegacion i kadetëve (viti i katërt) të Akademisë Ushtarake Tokësore të Turqisë. Delegacioni i kadetëve të Turqisë u prit në MFSK nga i drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, kolonel Ilir Qeriqi me bashkëpunëtorë. Së bashku me kadetët ishte edhe atasheu ushtarak i Turqisë në Prishtinë, kolonel Hasan Aydoglu dhe këshilltari i komandantit të FSK-së, kolonel Gultekin Yarali. Me këtë rast, gjeneral brigade Zymer Halimi i njoftoi kadetët me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për misionin, strukturën, bashkëpunimin regjional, SHBA-të, Gardën Kombëtare të Ajovës, NATO-n dhe në veçanti për bashkëpunimin me Turqinë. Kadetët e Akademisë Ushtarake të Turqisë gjatë takimit shprehen interesimin e tyre për të ardhmen e FSK-së, për krijimin e Forcave Ajrore, për Gardën Kombëtare dhe për Forcat Tokësore.



Certifikohen 38 pjesëtarë në kursin bazik të nënoficerit

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, më 24 nëntor 2014, u mbajt ceremonia e certifikimit të 38 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët për pesë javë rresht përfunduan me sukses kursin bazik të nënoficerit. Gjatë kësaj kohe ushtarët demonstruan shumë skenarë të ndryshëm të përgatitur nga instruktorët e Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve (QZHPU), çka e bëri kursin shumë sfidues por edhe tërheqës, për shkak se brenda për brenda ushtarët ishin të organizuar në ekipe dhe ato ekipe garonin se cili prej tyre do të arrijë rezultate më të mira gjatë ushtrimeve teorike dhe praktike. Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, në ceremoninë e certifikimit tha: "Mburremi me rezultatet tuaja për një sukses të përbashkët, duke ditur se kjo është gjenerata e dytë për këtë vit. Unë uroj që ju të angazhoheni në detyrat tuaja praktike, që të jeni shumë aktiv dhe t'i ndihmoni kolegët tuaj nëpër njësitë tuaja, ngase kjo është edhe një përvojë e re për ju dhe një ndihmë më shumë për njësitë tuaja".

Ai në fund, shtoi: "Ky është kursi i parë që kryen një ushtar i FSK-së për t'u avancuar në gradë dhe fillim i avancimit në karrierë, dhe, kjo nuk duhet parë si privilegj por si një përgjegjësi shtesë drejt bërjes së karrierës".

FSK-ja realizoi marshin kondicional

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj dhe Batalioni i Dytë i Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, më 17 nëntor 2014, realizuan marshimin kondicional. Ky aktivitet është realizuar në bazë të planit vjetor të trajnimeve të KDS-së dhe Batalionit të Dytë të BRSH-së. Qëllimi i marshimit ishte testimi dhe mbajtja e kondicionit fizik të pjesëtarëve të FSK-së në distanca të gjata. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, më 07 nëntor 2014, realizoi marshimin kondicional të koduar me emrin "Vjeshta 2014". Në këtë marshim kanë marrë pjesë 123 pjesëtarë të KDS-së si dhe 38 kadetë nga Kursi Bazik, ndërsa personeli ka qenë me pajisje personale duke i përfshirë edhe armët e gjata. Marshimi u realizua në rajonin e Ferizajt dhe të Suharekës. Edhe Batalioni i Dytë i BRSH-së marshimin e ka realizuar më 07 nëntor 2014 në lokacionin e Istogut. Të gjithë pjesëtarët pjesëmarrës e kanë përfunduar marshimin me sukses. Ky fakt dëshmon se pjesëtarët e këtij batalioni posedojnë përgatitje të lartë fizike dhe janë të gatshëm të përballojnë çfarëdo detyre dhe sfide. Në këtë marshim kanë marrë pjesë 142 pjesëtarë nga katër kompani të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë , përfshirë këtu edhe stafin komandues në krye me komandantin e saj, nënkolonel Mehmet Lladrovcin.



SPORT

FSK-ja për nder të Ditës së Forcës organizoi gara sportive

Në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, me rastin e shënimit të Ditës së Forcës, FSK-ja organizoi gara sportive në disa disiplina si në futboll, atletikë, shah dhe qitje me armë.

Garat u organizuan për dy javë rresht me aktivitete të ndryshme sportive. Pjesëmarrësit në këto gara treguan përgatitje të lartë fizike dhe efikasit të shkëlqyeshëm në çdo disiplinë.

Më 21 nëntor 2014 u zhvillua ndeshja finale ndërmjet dy ekipeve të Brigadës për Reagim të Shpejtë, atij të Batalionit të Parë dhe Batalionit të Tretë, ku fitues doli ekipi i Batalionit të Parë. Garat finale, nga afër, i përcollën zëvendëskomandanti i FSK-së njëherësh komandant i KFT-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, komandant i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Enver Cikaqi ,komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), shef i shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri si dhe ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe të NLAT-it.



Ekipet fituese sipas disiplinave u shpallën si në vijim:

Në disiplinën e shahut, vendin e parë e zuri Ferid Zhdrella -rreshter në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, vendin e dytë Feim Qorrolli- rreshter në KDS dhe në vendin e tretë u rendit rreshter Hilmi Zenun.

Në qitje me armë, vendi i parë i takoi Razim Berishës-kapter në KDS, vendi i dytë Afrim Musliut -tetar në Komandën e Forcave Tokësore dhe vendi i tretë Blerim Bytyqit -rreshter në Brigadën e Mbështetjes Operacionale.

Në garat e atletikës, në konkurrencën e femrave vendin e parë e zuri Liridonë Musaj- ushtare në Regjimentin e Mbrojtjes Civile, vendin e dytë Adelina Gashani-tetare në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe vendi i tretë i takoi Hidajete Hoxhës -ushtare në Regjimentin e Mbrojtjes Civile.



Ndërsa në konkurrencën e meshkujve vendin e parë e zuri Migjen Shalaushtar në Regjimentin e Mbrojtjes Civile, vendin e dytë Besnik Nebihu po ashtu ushtar në Regjimentin e Mbrojtjes Civile dhe në vendin e tretë u rendit Arben Vidishiqi - ushtar në Batalionin e Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë.

Në futboll, vendin e parë e zuri ekipi i Batalionit të Parë të BRSH-së, të dytin ai i Batalionit të Tretë të BRSH dhe vendin e tretë ekipi i Batalionit të Xhenios.

Organizimi i garave për nder të "Ditës së Forcës" tashmë është bërë traditë në FSK, ndërsa këto aktivitete çdo vit e më tepër po shkojnë duke u avancuar si në aspektin e organizimit, po ashtu edhe në atë të pjesëmarrjes kualitative dhe të konkurrencës ndërmjet ekipeve.

Në emër të FSK-së, zëvendës komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, i përgëzoi pjesëmarrësit dhe organizatorët e këtyre garave

Në fund, ekipet fituese dhe garuesit më të mirë u nderuan me medalje, kupa dhe mirënjohje, nga gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Enver Cikaqi, kolonel Naim Haziri dhe oficerë të NLAT-it.





FORCA JONË

□□□ Viti IV □ Nr. 33 □Prill 2015 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, Komandant i ri i Forcës së Sigurisë të Kosovës



Presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga më 18 mars 2015, ka dekretuar gradimin e gjeneralmajor Rrahman Ramës në gradën gjenerallejtënant si dhe me dekret të veçantë ka emëruar gjenerallejtënant Rrahman Ramën komandant të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Ceremonia e dorëzim-pranimit të detyrës së komandantit të FSK-së, u mbajt në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Me këtë rast, komandanti i deritanishëm, gjenerallejtënant Kadri Kastrati i dorëzoi Flamurin e FSK-së, Presidentes së Kosovës Atifete Jahjagës, e cila më pas ia dorëzoi Flamurin komandantit të ri të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës. Me këtë kalim të Flamurit të FSK-së nga Komandanti i mëparshëm përmes Presidentes tek Komandanti i ri, përfundon edhe akti i dorëzim-pranimit të detyrës së Komandantit të FSK-së. Pas këtij akti ushtarak, Komandanti i ri i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori detyrën e Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri i MFSK-së Haki Demolli priti një delegacion të Ministrisë së Mbrojtjes nga Mbretëria e Bashkuar



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), zotëri Haki Demolli më 18 mars priti një delegacion të Ministrisë së Mbrojtjes nga Mbretëria e Bashkuar të kryesuar nga Drejtori për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë zotëri Nick Gurr, i cili shoqërohej edhe nga ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë zoti Ian Cliff, Dominic Braitwait shef i Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK, Kolonel Richard Parry atashe ushtarak në Prishtinë, Luke Stivens dhe këshilltari ushtarak në MFSK kolonel David Jones. Gjatë takimit ministri Demolli i njoftoi mysafirët nga Mbretëria e Bashkuar për rrjedhat në FSK dhe MFSK, ceremoninë e dorëzim-pranimit të detyrës së komandantëve të FSK-së, procedurat dhe zhvillimin e procesit për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Ai me pas falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, për ndihmën e ofruar pjesëtarëve të FSK-së në trajnime dhe shkollim..

Zoti Gurr duke vlerësuar të arriturat e deritashme të FSK-së dhe bashkëpunimin e mirë të deritashëm të të dy ministrive edhe një herë shprehu gatishmërinë e Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar për të ndihmuar edhe në të ardhmen FSK-në dhe MFSK-në në realizimin e detyrave mbi bazën e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të dy ministrive përkatëse të nënshkruar vite më parë. Të pranishëm në takim ishin edhe komandanti FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së zoti Shkëlzen Sylaj dhe Shefi i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri Kolonel Ilir Qeriqi. Delegacionin e Mbretërisë së Bashkuar në takim të veçantë e priti edhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama.



Vizitë zyrtare e Ministrit dhe Komandantit të FSK-së në Republikën e Kroacisë

Ministri Haki Demolli dhe gjenerallejtënant Rrahman Rama u pritën nga Presidentja e Kroacisë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 24 mars 2015, gjatë vizitës zyrtare që i bënë Kroacisë, u pritën në Zagreb nga Presidentja e Republikës së Kroacisë, znj. Kolinda Grabar- Kitaroviq. Gjatë takimit të përbashkët të ministrit Demolli dhe Presidentes Grabar-Kitaroviq u konfirmuan edhe një herë marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet të dyja shteteve, si dhe dëshira e dyanshme për zgjerimin e bashkëpunimit të suksesshëm në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Ministri Haki Demolli e falënderoi Presidenten Grabar- Kitaroviq për bashkëpunimin dhe mbështetjen e deritanishme që shteti i Kroacisë ka dhënë Forcës së Sigurisë dhe shtetit të Kosovës, si dhe ka potencuar një varg rezultatesh konkrete nga ky bashkëpunim, sidomos në fushën e trajnimeve dhe shkollimeve ushtarake. Nga ana e saj, Presidentja e Republikës së Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviq ka ritheksuar se Republika e Kroacisë do të vazhdojë të mbështesë Republikën e Kosovës në proceset e ardhshme të reformave si dhe në rrugën drejt aspiratës së saj për integrime euro-atlantike. Gjithashtu, gjatë takimit u bisedua për mundësitë e bashkëpunimit në industrinë ushtarake, siç u konfirmua ekspozita e ardhshme ushtarake në hapësirën ajrore të Adriatikut(ASAD 2015), në Split, të cilën pala kosovare ka për qëllim ta vizitojë. Kjo ishte vizita e parë zyrtare në shtetin e Kroacisë e ministrit Demolli dhe gjeneral Ramës prej që ministri dhe komandanti kanë marrë detyrat për të drejtuar Ministrinë, përkatësisht Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së në konferencën e NATO-s në Bruksel

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri i MFSK-së, kolonel Ilir Qeriqi së bashku me një delegacion të Qeverisë së Republikës të Kosovës me ftesë të Misionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në NATO, morën pjesë në një vizitë dy ditore në Bruksel, në takime dhe konferenca punuese të organizuar nga NATO.

Gjatë qëndrimit në Bruksel, ministri dhe komandanti kanë pasur takime të shumta pune që kishin të bënin me çështjet e sigurisë, mundësitë e trajnimit dhe shkollimit ushtarak, bashkëpunimit ushtarak dhe rolin e NATO-s në Kosovë dhe më gjerë.

Ministri Demolli dhe gjeneral Rama u priten me nderime të larta shtetërore në Ministrinë e Mbrojtjes të Kroacisë



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, u priten me nderime të larta shtetërore në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë. Fillimisht ministri Demolli dhe ministri kroat i Mbrojtjes Ante Kotromanoviq parakaluan para Gardës Ceremoniale dhe nderuan himnet shtetërore të dyja vendeve, Kosovës dhe Kroacisë. Ministri i FSK-së, Haki Demolli dhe ministri Ante Kotromanoviq zhvilluan takim kokë me kokë ku diskutuan një varg çështjesh që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes së dy vendeve. Më pas u zhvillua takim i përbashkët i të dyja delegacioneve, në të cilin u fol mbi bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, si dhe gatishmërinë e të dyja palëve për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen. Gjithashtu, në Ministrinë e Mbrojtjes u nënshkrua edhe Plani dypalësh i bashkëpunimit për vitin 2015, ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë. Në emër të MFSK-së, memorandumin e nënshkroi kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim, Siguri dhe Marrëdhënie me Jashtë dhe në emër të Ministrisë të Mbrojtjes të Kroacisë, Petar Mihatov, shef i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Kjo është vizita e parë zyrtare e delegacionit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Republikën e Kroacisë, prej që ministri Haki Demolli dhe komandanti, gjeneral Rama kanë marrë drejtimin e MFSK-së dhe FSK-së.



Gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim ambasadoren e Republikës së Turqisë




Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama prit në takim ambasadoren e Republikës së Turqisë në Kosovë, zonjën Songul Ozan, të shoqëruar nga atasheu ushtarak, kolonel Hasan Aydogdu dhe këshilltarin ushtarak të komandanti të FSK-së, kolonelin Gultekin Yarali. Gjatë takimit, gjenerallejtënant Rama e njoftoi ambasadoren Ozan mbi proceset në FSK, trajnimet, shkollimet dhe stërvitjet që po zhvillohen sipas planeve vjetore dhe njëherësh u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë. Komandanti i FSK-së falënderoi ambasadoren Ozan për ndihmën e pakursyer që po jep Ministria e Mbrojtjes dhe Republika e Turqisë në këtë fushë. Ai u shpreh i gatshëm për vazhdimin e bashkëpunimit edhe më të mirë dypalësh ndërmjet Kosovës dhe Turqisë. Nga ana e saj, ambasadorja Ozan i uroi gjenerallejtënant Rrahman Ramës, gradimin si dhe emërimin në detyrën e komandantit të FSK-së. Po ashtu, ambasadorja e Turqisë në Kosovë ka siguruar gjeneral Ramën se bashkëpunimi ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura do të vazhdojë me intensitet të njëjtë edhe në të ardhmen, në fushat me interes të përbashkët. Ajo theksoi se edhe në të ardhmen, Turqia do të vazhdojë ta mbështes dhe përkrah zhvillimin dhe modernizimin e FSK-së. Kjo është vizita e parë e ambasadores së Republikës së Turqisë në Kosovë, Songul Ozan, bërë FSK-së, prej se gjenerallejtënant Rrahman Rama është emëruar Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati u dekorua nga Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga me "Urdhrin e Pavarësisë"



Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga më 13 mars 2015, ka dekoruar komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati me ,,Urdhrin e Pavarësisë". Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm edhe kryeministri i Republikës së Kosovës Isa Mustafa, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, zëvendëskomandanti i FSK-së dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT), gjeneral major Rrahman Rama dhe sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z Shkëlzen Sylaj. Presidentja e vendit, znj. Atifete Jahjaga falënderoi gjenerallejtënant Kadri Kastratin me rastin e përfundimit të detyrës së tij si komandant i FSK-së, për përkushtimin e tij shumëvjeçar në ndërtimin e këtij institucioni shembull të Republikës së Kosovës. Ajo tha se gjenerallejtënant Kastrati po e përmbyll këtë detyrë, duke lënë pas vete një institucion profesional, të gatshëm për të marrë përgjegjësitë që i takojnë në garantimin e sigurisë kombëtare, që ngërthen në vete vlerat dhe idealet e Republikës së Kosovës dhe aspiratën tonë për të qenë pjesë e infrastrukturës euroatlantike të sigurisë. "Nën udhëhecjen tuaj e kemi parë FSK-në të ngritët mbi çdo sfidë, të fuqizohet dhe të kalojë barriera fizike, me shtrirjen e dorës së ndihmës secilit qytetar të Kosovës. Ju keni dhënë kontribut të çmueshëm për ndërtimin e vizionit për të ardhmen e FSK-së dhe transformimin e kësaj force në Forcat e Armatosura të Kosovës, një përgjegjësi që u mbetet ta jetësojnë pasardhësit tuaj", tha Presidentja Jahjaga. Në vijim të ceremonisë, për rolin dhe kontributin e dhënë në shërbim të shtetit tonë, në forcimin dhje konsolidimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe ndërtimin e këtij institucioni shtyllë të vendit tonë, Presidentja Jahjaga e dekoroi gjenerallejtënant Kadri Kastratin me Urdhrin e Pavarësisë. Nga ana e tij, gjeneral Kastrati falënderoi Presidenten Jahjaga për vlerësimin për punën e tij, falënderoi ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FSK-së, ministrin e FSK-së, për përkrahjen e vazhdueshme për zhvillimin dhe transformimin e FSK-së.

Komandanti i FSK-së gjeneral Rama takoi shefin e ushtrisë shqiptare gjeneralin Bazo



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama më 31 mars 2015, priti në takim shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneral major Jeronim Bazo me bashkëpunëtorë. Gjenerallejtënant Rrahman Rama, për herë të parë në cilësinë e komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, fillimisht i shprehu mirëseardhjen gjeneralit Bazo duke e falënderuar, njëherësh, për mbështetjen dhe përkrahjen e jashtëzakonshme që kanë dhënë Forcat e Armatosura Shqiptare dhe Ministria e Mbrojtjes për ngritjen, zhvillimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama e njoftoj gjeneral Bazon mbi zhvillimet në FSK, operacionet, trajnimet, shkollimet si dhe planet rreth forcës për të ardhmen. Gjithashtu gjeneral Rama foli edhe për planin e bashkëpunimit dypalësh me Republikën e Shqipërisë si dhe për një varg aktivitetesh me interes të përbashkët për të ardhmen. Nga ana e tij shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneral major Jeronim Bazo, pasi e uroi komandantin e FSK-së për gradën dhe detyrën e re, konfirmoi edhe njëherë zotimin dhe gatishmërinë për bashkëpunim në të gjitha fushat në bazë të Marrëveshjes zyrtare të bashkëpunimit ndërmjet të dyja Forcave dhe të dyja vendeve edhe në të ardhmen. Kjo ishte vizita e parë e shefit të shtabit të Ushtrisë së Republikës së Shqipërisë në FSK, prej që gjenerallejtënant Rrahman Rama është emëruar komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Lagjja Emshir, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org



Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, vizitoi Brigadën për Reagim të Shpejtë

Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), zhvilloi një vizitë në repartet e Komandës së Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), në kazermën ,,Ushtarët e NATO-s", në Istog. Fillimisht delegacioni parlamentar në krye me kryetarin e Komisionit Parlamentar, zotëri Daut Haradinaj, u priten nga zëvendëskomandanti i FSK-së, njëherësh komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral major Rrahman Rama, ushtruesi i detyrës së komandantit të Komandës së Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, dhe nënkolonel Mehmet Lladrovci, komandant i Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë, me bashkëpunëtorë. Gjeneral Rama dhe kolonel Lladrovci i njoftuan parlamentarët e Kuvendit të Kosovës, mbi zhvillimin e BRSH-së, përfshirë objektivat për këtë vit, trajnimet, shkollimet, gatishmërinë për reagim brenda dhe jashtë vendit, etj. Gjithashtu, zotëri Daut Haradinaj, në emër të Komisionit i përgëzoi komandantët, stafin komandues si dhe ushtarët, për të arriturat duke iu premtuar mbështetje dhe përkrahje pa rezervë për FSK-në, si dhe përkrahje dhe mbështetje edhe gjatë procesit të transformimit. Për të parë më afër angazhimet për zbatimin e misionit, realizimin e detyrave për parlamentarët që janë anëtarë të Komisionit për Siguri, një prezantim të shkurtër në emër të Komandës së BRSH-së e paraqiti, major Ejup Maqedonci, ushtrues detyre i shefit të Shtabit të BRSH-së. Gjatë vizitës, anëtarët e Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së së bashku me gjeneral Ramën, kolonel Gecin dhe oficerët tjerë të BRSH-së, përcollën operacione të simuluara, pra stacione trajnuese si: reagimi në kontakt dhe pika kontrolli. Gjatë kësaj paraqitje pjesëtarët e Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë, treguan nivel të lartë të përgatitjes fizike, taktike dhe vepruese. Në përbërje të delegacionit nga Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ishin edhe Ganimete Musliu, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe koordinatori i Komisionit, Nur Çeku.

Në FSK u certifikuan trajnerët e deminimit dhe u pranua një donacion në pajisje



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli dhe gjenerallejtënant Rrahman Rama morën pjesë në ceremoninë e certifikimit të trajnerëve për deminim, eliminim të mjeteve të pashpërthyera dhe pastrim të fushëbetejave. Gjatë kësaj ceremonie u zhvillua edhe pranim-dorëzimi i një donacioni me pajisje shkollore dhe operacione të deminimit, e dhuruar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë. Lidhur me këtë, ministri Demolli tha se ekzistimi i zonave të minuara dhe njëkohësisht edhe zonave të afektuar nga to, nuk përbën vetëm rrezik potencial për jetën e njerëzve por edhe e rëndon gjendjen ekonomike të banorëve në këto zona, për shkak të pamundësisë për të pasur qasje në pronat e tyre. Mënjanimi i mjeteve të rrezikshme, nga ato zona është një parakusht për shfrytëzimin e resurseve të saja natyrore. Sipas tij për këtë arsye Njësitë e Deminimit të FSK-së janë duke punuar në krijimin e një mjedisi të sigurt nga minat dhe mjetet tjera eksplozive të pashpërthyera. "Që nga viti 1999 e këndej në Kosovë janë pastruar gjithsejtë mbi 49 milion metra katror sipërfaqe dhe janë eliminuar 87 mijë e 162 mjete të pashpërthyera"- tha Demolli.
Demolli po ashtu theksoi se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme FSK-në në këtë fushë, si me trajnime, pajisje e mbështetje tjera.
Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, u shpreh mirënjohës dhe falënderues ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Komandës së SHBA-ve për Evropë.
Rama uroi gjithashtu edhe trajnerët e rinj të FSK-së për arritjet në përvetësimin e programit.
Në ceremoni ishte e pranishme edhe e ngarkuara me punë pranë Ambasadës Amerikane në Prishtinë, Jenifer Bacus e cila u shpreh se është e lumtur që gjendet në mesin e pjesëtarëve të FSK-së të cilët u certifikuan sot. Në fund të ceremonisë, ministri Demolli, përfaqësuesja e Ambasadës amerikane, zonja Bacus si dhe gjeneral Rama ndanë certifikatat për 15 pjesëtarët që mbaruan trajnimin "trajno trajnerët" për deminim, si dhe u bë pranim-dorëzimi i donacionit me pajisje shkollore dhe për operacione të dominimit



Gratë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës shënuan 8 Marsin



Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsi, gratë ushtarake dhe shërbyese civile në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), mbajtën një takim të përbashkët për nderë të shënimit të kësaj feste. Takimin e hapi shefja e Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MFSK, zonja Halime Morina, e cila ndër të tjera tha se kjo ditë shërben jo vetëm për bashkimin e grave pa dallim feje, race, kulture, gjuhe dhe prejardhjeje, por dhe për të kujtuar përpjekjet për barazi, paqe, drejtësi në shoqëri. Pastaj zonja Morina shtoi se: "Në MFSK/FSK është punuar dhe punohet për çdo ditë për një ambient të përshtatshëm dhe pa diskriminim, për një sistem vlerash ku femrat trajtohen me dinjitet dhe kanë mundësi të barabarta." Zonja Halime Morina gjithashtu, në mënyrë të veçantë i uroj femrat ushtarake me rastin e kësaj dite, duke çmuar punën dhe sakrificën e tyre. "Puna e a juaj, nuk ka qenë dhe nuk do të jetë e lehtë por, ne të gjitha kemi një qëllim të përbashkët, të punojmë për të ardhmen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Republikës së Kosovës për t'i realizuar synimet tona të përbashkëta, si shoqëri. Në takim gjithashtu u zhvillua debat i hapur rreth rolit dhe kontributit të femrave në Ministri dhe Forcë, si dhe avancimit të rolit të femrën në institucionin tonë. Rreth temës diskutuan, Fahrije Sadiku drejtoresh e Departamentit për Menaxhimin e Financave, Krenare Sogojeva-Dermaku, shefe e Zyrës Ligjore dhe Lumnije Sadriu e Hidajete Rexha. Duhet cekur se vajzat dhe gratë në shërbim në Ministri dhe Forcë, tani përbëjnë një numër të konsiderueshëm, si në uniformë po ashtu edhe si shërbyes civil, ato shërbejnë me sukses në të gjitha strukturat e MFSK-së dhe të FSK-së, duke treguar profesionalizëm, përkushtim, motivim dhe disiplinë. MFSK, angazhohet për barazi ndërmjet gjinive si vlerë e domosdoshme për zhvillimet demokratike në shoqërinë kosovare. Arritja e balancës gjinore, forcimi i rolit të femrave në vendimmarrje, ngritja e kapaciteteve edukative në sektorin e sigurisë, fuqizimi i mekanizmave institucionalë për barazi gjinore sipas legjislacionit në fuqi dhe politikave aktuale mbetet një nga prioritetet e rëndësishme për të ardhmen, që mund të themi se ky ishte edhe konkluzion i takimit, me rastin e 8 Marsit- Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Në fund të gjitha grave që punojnë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës iu dhurua nga një vazo me lule të freskëta.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim atasheun ushtarak të Republikës Federale të Gjermanisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim atasheun ushtarak të Republikës Federale të Gjermanisë, nënkolonel Rupert J.J. Steeger. Gjeneral Rama, shprehu konsideratën e tij për angazhimin dhe mbështetjen që Forcat e Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin për FSK-në, si gjatë ngritjes së kapaciteteve të plota operacionale, e po ashtu edhe në fazën e tanishme në të cilën gjendemi. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama e falënderoi atasheun për vizitën dhe e njoftoi atë mbi zhvillimin e FSK-së, trajnimet, shkollimet dhe stërvitjet që po zhvillohen sipas planifikimeve në bazë të planit dypalësh. Gjithashtu, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura të shtetit të Gjermanisë, duke shprehur kështu edhe kënaqësinë e tij për vazhdimin e këtij bashkëpunimi. Gjatë takimit, atasheu ushtarak nënkolonel Rupert Steeger i uroi gjenerallejtënant Rrahman Ramës, gradimin si dhe emërimin në detyrën e komandantit të FSK-së, ai njëherësh shprehu gatishmërinë për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe FA të Republikës Federale të Gjermanisë. Ai e siguroi edhe njëherë gjeneralin Rama se mbështetja dhe përkrahja për FSK-në, si dhe bashkëpunimi ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura do të vazhdoj me intensitet të njëjtë edhe në të ardhmen, në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandant i ri i Forcës së Sigurisë të Kosovës

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) më 18 mars 2015, u mbajt ceremonia e ndërrimit të komandantit të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Në ceremoni morën pjesë: Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, kryeministri i Kosovës Isa Mustafa, ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, zëvendëskomandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Francesco Paolo Figliuolo, ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) Tracey Ann Jacobson, oficerë të FSK-së, të KFOR-it, ambasadorë dhe atashe të akredituar në vendin tonë, ministra, deputetë të Kosovës, personalitete politike, kulturore dhe familjarë të oficerëve. Ceremonia e ndërrimit të komandantit të FSK-së filloi me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të FSK-së nga Presidentja Atifete Jahjaga dhe Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, duke vazhduar me intonimin e himnit shtetërorë të Kosovës. Në fjalën e saj, Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga pasi përshëndeti të pranishmit, përgëzoi FSK-në për të arriturat e tarësimin në këtë aleancë". Në fund, znj. Jahjaga falënderoi komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastratin për angazhimin edhe punën e palodhur në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së, si dhe i uroi punë të mbarë komandantit të ri, gjenerallejtënant Rrahman Ramës. Ndërsa, kryeministri i Kosovës Isa Mustafa në fjalën e tij, tha: "Ceremonia e sotme e ndërrimit të komandës së Forcës së Sigurisë së Kosovës, është një akt solemn dhe një tregues i vazhdimësisë së zhvillimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës drejt themelimit të Forcave të Armatosura të Kosovës. Është ky një institucion tepër i rëndësishëm dhe i respektuar i Republikës së Kosovës. Kryeministri Mustafa falënderoi komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin për punën dhe kontributin e tij të rëndësishëm për ngritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai më pas shtoi: "Ne kemi besim të plotë se gjeneral major Rrahman Rama në bashkëpunim dhe bashkërenditje të plotë me Ministrinë e Forcës së Sigurisë do të vazhdojë me sukses rrugën e zhvillimit dhe rrugën e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Prandaj, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës i uroj gjeneral Ramës dhe të gjithë juve suksese në të ardhmen". Komandanti i deritanishëm i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në fjalimin tij lamtumirës u shpreh se ndihet shumë i emocionuar dhe i nderuar me këtë ceremoni të organizuar me rastin e përfundimit të detyrës si komandant i FSK-së. Gjeneral Kastrati në fjalën e tij, foli gjerësisht për të arriturat e përgjithshme të FSK-së dhe për të ardhmen e saj drejtë transformimit në Forcat e Armatosura të Kosovës. Ndërsa, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli dekoroi komandantin e deritanishëm të FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastratin me "Dekoratën për Shërbim të Shquar". Ceremonia e dorëzim-pranimit të detyrës së komandantit filloi pas leximit të dekretit të Presidentes për gradimin e gjeneralmajor Rrahman Ramës në gradën gjenerallejtënant dhe dekretit për emërimin e gjenerallejtënant Rrahman Ramës komandant i FSK-së, ku komandanti i deritanishëm, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me ceremoni ushtarake i dorëzoi Flamurin e FSK-së, Presidentes së Kosovës Atifete Jahjagës, e cila më pas ia dorëzoi Flamurin komandantit të ri të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës. Me këtë kalim të Flamurit të FSK-së nga Komandanti i mëparshëm përmes Presidentes tek Komandanti i ri, përfundon edhe akti i dorëzim-pranimit të detyrës së Komandantit të FSK-së.







danti i FSK-së gjeneralmajor Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Francesco Paolo Figliuolo, ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) Tracey Ann Jacobson, oficerë të FSK-së, të KFOR-it, ambasadorë dhe atashe të akredituar në vendin tonë, ministra, deputetë të Kosovës, personalitete politike, kulturore dhe familjarë të oficerëve. Ceremonia e ndërrimit përgjithshme: "Ne kemi përmbyllur me sukses një periudhë të rëndësishme të Forcës së Sigurisë, duke hapur një kapitull të ri për ju dhe për gjithë vendin: krijimin e një Force moderne të armatosur, me kapacitete mbrojtëse, që adreson sfidat e sigurisë, e kompleton infrastrukturën tonë të sigurisë dhe në proces e sipër të profesionalizimit me standarde të NATO-s dhe që synon anë-









FSK-ja shënoi 17- vjetorin e Epopesë së UÇK-së me ceremoni ushtarake

Manifestimi qendror në shënimin e 17- vjetorit të Epopesë së UÇK-së, më 5, 6 dhe 7 mars 2015, në nderim të Komandanti Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit u mbajt në Kazermën "Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë. Përvjetori i 17-të i rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari u mbajt nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa. Në këtë manifestim morën pjesë: kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës z. Kadri Veseli, kryeministri i Kosovës Isa Mustafa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, ambasadorë, ministra, deputet, veteranë, invalidë dhe përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, drejtues të institucioneve shtetërore të Kosovës, qytetarë dhe nxënës të shkollave të Kosovës. Manifestimi filloi me intonimin e himnit shtetëror të Republikës së Kosovës ekzekutuar nga Orkestra Frymore e FSK-së. Pas revistës, kryetari i Parlamentit Kadri Veseli, kryeministri Isa Mustafa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati dhe Smajl Elezaj përfaqësues i Shoqatave të Dala nga Lufta e UÇK-së, vendosen kurora me lule pranë Obeliskut të Dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri. Në manifestimin "Epopeja e UÇK-së", me një fjalë tematike u paraqitën, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, kryeministri Isa Mustafa dhe në emër të familjes Jashari dhe familjeve të dëshmorëve, përshëndeti Bekim Jashari. Kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, në fjalën e tij, tha: "Republika e Kosovës sot shënon një datë të veçantë të historisë së saj të re, 5 marsin, ditën e rënies heroike të Heroit të Kosovës, Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari. Ditët e Epopesë së UÇK-së nuk reshtën deri më 12 qershor 1999, kur Kosova u çlirua përfundimisht dhe së bashku me përkrahjen e botës demokratike nisi një fazë të re, atë të shtet ndërtimit të paqes dhe zhvillimit Kryeministri shprehu mirënjohje të thellë për përkrahjen e vendeve demokratike, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-s, që në ditët më të vështira na dolën krah dhe së bashku me ta vulosëm lirinë tonë, ka thënë më tej kryeministri."17-vjetori i rënies së Adem Jasharit dhe bashkë familjarëve të tij e gjen Kosovën me shumë arritje; Kosova e njohur nga 108 shtete, anekënd globit, ka vënë marrëdhënie të ngushta me shumë vende të botës, duke e forcuar subjektivitetin e saj ndërkombëtar dhe duke shënuar rezultate të prekshme në çdo fushë të jetës". Për krijimin e Forcave të Armatosura, kryeministri Mustafa tha: "Transformimi i UÇK-së në TMK dhe i kësaj të fundit në FSK është vetëm një nga rrëfimet e



shumta të suksesit të Kosovës së lirë, sovrane e demokratike. Kuptohet, procesi i avancimit të FSK-së do të vazhdojë më tej me themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, të cilat do të jenë forca moderne ushtarake, të pajisura me të gjitha cilësitë e nevojshme të një ushtrie të aftë për të siguruar stabilitet e paqe dhe për të marrë pjesë në misione humanitare e paqësore me synim që të ketë vendin e vet në NATO". Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në manifestimin për shënimin e 17 vjetorit të Epopesë së UÇK-së, tha se: "Rezistenca dhe sakrifica e familjes Jashari në kullat e Jasharajve ishte dhe do të mbetet frymëzim për brezat e ardhshëm, duke na përkujtuar se sa e shtrenjtë është liria", për të shtuar se, "FSK-ja është forcë e të rinjve, forcë e brumosur me të kaluarën e lavdishme, si dhe forcë që po punon aktivisht për të ndërtuar të ardhmen. FSK-ja është institucioni i sigurisë më i besueshëm në vend. Kjo është arritur falë punës së palodhshme dhe përkushtimit të gjithë pjesëtarëve të saj". Ndërsa, për të arriturat e FSK-së, gjeneral Kastrati tha: "Pjesëtarët tanë sot shkollohen nëpër shkolla dhe akademi prestigjioze anekënd botës, përfshirë edhe ato të NATO-s, ku po tregojnë rezultate të larta. FSK ka treguar se është e gatshme që të dislokohet shpejt dhe të përkrah vendeve të rajonit, siç ishte rasti i vërshimeve të fundit në Shqipëri". Për transformimin e FSK-së në FAK, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, tha: "Tashmë, FSK ka përfunduar një proces të gjatë të ngritjes dhe zhvillimit profesional dhe po përgatitet për transformimin e saj në FAK, transformim ky që do të përmbyll një rrugëtim të gjatë të angazhimeve tona. Ky nivel është arritur falë përkrahjes së vazhdueshme të SHBA-ve dhe partnerëve tanë, të cilët na kanë ndihmuar dhe po vazhdojnë të na ndihmojnë në arritjen e standardeve profesionale". Në emër të familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve , manifestimin e përshëndeti Bekim Jashari, djali i Hamëz Jasharit. Në kuadër të manifestimit "Epopeja e UÇK-së", ministri Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati ndanë medalje për ushtarët, nënoficerët, oficerët dhe stafin civil të dalluar të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ceremonia ushtarake u mbyll me Marshin ushtarak të ekzekutuar nga Orkestra Frymore e FSK-së.



Ministri dhe Komandanti i UÇK-së nënë përvjetorin e 17-të të Epopesë së UÇK-së nënë homazhe në Prerallohe vitëtan Adijen Jashari

Në shënimin e 17- vjetorit të Epopesë së UÇK-së, dhe në nderim të Komandanti Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit, një delegacion i MFSK-së dhe FSK-së, vizitoi Prekazin dhe familjen Jashari. Ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastratin, sekretarin e përgjithshëm të MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, komandantin e KFT-së, gjeneral major Rrahman Rama si dhe gjeneralë dhe oficerë të lartë të Ministrisë dhe FSK-së, në përvjetorin e 17-të të Epopesë së UÇK-së, vizituan Kompleksin Memorial "Adem Jashari" ku bënë homazhe dhe vendosën lule në shenjë ndjerimi dhe respekti për Komandantin Legjendar Adem Jashari, familjen Jashari dhe të gjithë dëshmorët e UÇK-së. Delegacioni i FSK-së u prit edhe në Kullën e Familjes Jashari nga Murat Jashari dhe pjesëtarë tjerë të kësaj familje. Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati në emër të delegacionit të FSK-së, çmoj lartë sakrificën e pashembullt të Komandantit Legjendar dhe të familjes Jashari. Në emër të familjes Jashari, delegacionin e FSK-së, e falënderoi Murat Jashari, nipi i Komandantit Legjendar Adem Jasharit.



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, dekoroi pjesëtarët e dalluar të FSK-së

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), në një takim të veçantë, solemnisht u dha medalje për "Shërbim vetëmohues" për oficerët dhe nënoficerët e dalluar të FSK-së. Me dekoratën për "Shërbim vetëmohues" gjeneral Kastrati dekoroi gjeneral brigade Bashkim Jasharin. Me rastin e Manifestimit "Epopeja e UÇK-së" komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati bazuar në nenin 27 dhe 28 të Rregullores 05/2013 për medalje dhe mirënjohje për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ka dekoruar me medalje oficerët dhe nënoficerët e dalluar, për kontributin dhe rezultatet e treguara në punë: kolonel Skënder Zhitin, nënkolonel Afrim Veselin, majorët; Brahim Kokollarin, Behxhet Shalën, Hajrullah Rrecaj, Binak Zekaj, Estref Oruçin dhe Afrim Berishën, kapitenët; Sejdi Elezin dhe Zekirja Shkretën dhe tetar Ali Hoxhën.

Gratë në FSK me sukses dhe përgjegjësi të lartë i kryejnë detyrat ushtarake

Për të arriturat, sfidat dhe sukseset e FSK-së, më 8 mars, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, biseduam me gratë të cilat shërbejnë në Ministrinë e FSK-së dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës; kolonel Irfete Spahiu, zëvendës komandant i KDS-së, Krenare Dermaku drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Vineta Klein, këshilltare e Ekipit Këshillues të NATO-s, ushtaret Ermira Statovci dhe Arbëresha Bytyqi

Kolonel Irfete Spahiu zëvendëskomandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj

Gazeta Forca Jonë: Si ushtarake e lartë e FSK-së, me gradën kolonel, sa po arrini t'i kryeni detyrat e përgjithshme, kur dihet se jeni edhe zëvendëskomandant e KDS-së?
Kolonel Spahiu: Nëse i referohem pozitës aktuale në FSK/KDS, mirë, angazhim i përditshëm që nuk mund të them i palodhshëm e pa preokupim; me obligim, përgjegjësi por njëkohësisht edhe kënaqësi kur ke mundësi që të shohësh se po bën diçka për gjeneratat e reja, popullin dhe vendin tënd.



Gazeta Forca Jonë: Sa respektohen të drejtat e femrave në FSK, në institucionin më të besueshëm për qytetarët e Kosovës?
Kolonel Spahiu: Ndihem vërtetë mirë të flas për të drejtat e femrës në FSK por edhe për drejtat në përgjithësi. Edhe pse pjesëtarët femra në FSK vlerësohen si pjesëtarë të FSK-së, jo pse janë femra, me gjithë specifikat nuk ka dallim gjinor të theksuar që kanë qenë objekt i trajtimit të kodit të mirësjelljes e kjo është një tregues i mirë për një institucion si FSK me gjithë specifikat e veta. Por kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për të bërë më shumë, gjithsesi. Unë i referohem gjithherë asaj se për të pasur sukses duhet punë, angazhim profesional për ta arsyetuar dhe bindur së pari vetveten se je e barabartë me të tjerët e jo t'u referohemi kuotave /%/.

Gazeta Forca Jonë: Tetë marsi festa e grave është afër, si e konceptoni këtë ngjarje për gratë në përgjithësi ?
Kolonel Spahiu: Unë personalisht nuk e kam festuar si festë, por sa mbaj mend një lule kam pas çdo herë për nënën time jo më shumë. Ndoshta edukata familjare pa marrë parasysh rrethanat e kohës kanë ndikuar që 365 ditët e vitit të iu referohem si të pa ndara.

Vineta Kleine, këshilltare e Ekipit Këshillues të NATO-s

Ushtaret e FSK-së me krenari bartin uniformat dhe me përkushtim i ndihmojnë vendit dhe popullit të tyre

Unë jam në Kosovë që nga nëntori i vitit 2011 kur jam bërë pjesë e Ekipit Këshillues të NATO-s, i cili e mbështet dhe e ndihmon Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në punën time si Këshilltare për Marrëdhënie me Publikun, unë shpesh i vizitoj njësitë e FSK-së dhe takohem me femra që shërbejnë në FSK. Më ka lënë shumë mbresa femininiteti i tyre, inteligjenca, krenaria me të cilën e bartin uniformën dhe përkushtimi për t'i ndihmuar vendit dhe popullit të tyre. Shumë prej këtyre femrave nuk e kanë pasur jetën e lehtë, por nuk kanë hequr dorë nga ëndrrat e tyre; përkundrazi, ato janë plot optimizëm e shpresë. Ajo që kam kuptuar këtu në Kosovë është se femrat në çfarëdo rrethanash e ruajnë forcën e brendshme, qasjen femërore dhe përpiqen të jenë të bukura. Unë jam letoneze dhe ashtu si femrat kosovare, edhe ne letonezet jemi krenare për kulturën tonë dhe besnike ndaj familjeve tona; edhe ne i ruajmë traditat, por mbetemi të hapura ndaj progresit. Për dallim nga femrat kosovare, letonezet janë më të rezervuara dhe çështjet personale zakonisht nuk i diskutojnë me shoqe. Por pavarësisht



nga kjo, ne femrat letoneze dhe kosovare dëshirojmë të trajtohemi me respekt dhe presim që puna dhe arritjet tona të njihen dhe të vlerësohen. Kjo thjesht na jep krahë dhe na motivon të bëjmë më shumë.

Arbëresha Bytyqi, gjenerata 2015, sapo ka filluar trajnimin bazik në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj

Gazeta Forca Jonë: Profesioni i ushtares është mjaft sfidues, çfarë ju shtyri ta zgjedhin ?
Arbëresha Bytyqi: Fillimisht mendojë se profesioni i ushtarit është profesion fisnik edhe pse është mjaftë sfidues është kënaqësi dhe nder që të kontribuosh për vendin. Jam e privilegjuar që kam fituar mundësinë që të jem rekrute e kësaj gjenerate, të jesh pjesë e ushtrisë, mendoj se është një rrugëtim më ndryshe.

Gazeta Forca Jonë: Si e keni festuar 8 Marsin më parë dhe si tani si pjesë e FSK-së ?
Arbëresha Bytyqi: Nuk e kam festuar personalisht unë, por këtë festë gjithmonë ia kam uruar nënës sime,



mësues dhe shoqeve me nga një trëndafila të kuq, ndërsa, në FSK-së, besojë se edhe këtu ka një traditë të urimit të kësaj feste. Por, unë 8 Marsin e kuptojë, jo vetëm si dita e femrave, por se duhet të jetë edhe një ditë e përkushtimit tonë, për të punuar edhe më shumë në rrugëtimin tonë.

Gazeta Forca Jonë: Si e re në këtë profesion, sa e keni të vështirë të përshtateni me detyrat dhe me disiplinën në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes?
Arbëresha Bytyqi: Ushtria është sfiduese, jam e lumtur që jam pranuar si pjesë e grupit të ri të rekrutëve të gjeneratës së parë 2015. Po ndihem mirë. Është pak më ndryshe jeta civile të cilën ne e bëjmë në jetën tonë të përditshme, jemi pjesë e rregullave dhe komandave të cilave ne mundohemi t' ju bindemi. Po fillojmë një realitet të ri, një profesion ushtarak dhe ne po bëhemi pjesë e një ushtrie të mirëfilltë.

Krenare Sogojeva-Dermaku, drejtoreshë e Departamentit Ligjor në MFSK

Gazeta Forca Jonë: A mund të na thoni si shënohet 8 Marsi në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës?
Krenare Dermaku: Festa e 8 Marsit si ditë ndërkombëtare e gruas, shënohet anë e kënd botës si reflektim mbi kurajën e grave për realizimin dhe afirmimin e të drejtave të tyre, për krijimin e një shoqërie pa dallime gjinore. Kjo ditë shënohet edhe në shoqërinë tonë, andaj edhe Ministria për Forcën e Sigurisë vite me radhë organizon tryeza dhe debate me tematika mbi të drejtat e gruas apo edhe ceremoni të vogla festive, duke shënuar këtë ditë në përshtatje me rëndësinë dhe simbolikën që ka.

Gazeta Forca Jonë: Ju zonja Dermaku si e shihni kooperimin në realizimin e detyrave ditore në mes përfaqësuesve të dy gjinive?
Krenare Dermaku: Duke qenë se puna profesionale dhe marrja e përgjegjësive gjithherë matet me vlera dhe jo me gjini, nga perspektiva ime dhe ambienti që më rrethon në punë, ndihem krejtësisht e barabartë dhe asnjëherë, në asnjë situatë, nuk kam hasur në ndonjë diskriminim gjinor, që do të mund ta vë në pah ndonjë dallim të tillë.



Gazeta Forca Jonë: A është sfiduese për gratë, kur dihet se burrat i kanë 365 ditë gjatë vitit, dhe vetëm një ditë, është për gratë?
Krenare Dermaku: Personalisht nuk kam një koncept të tillë, pra nuk e shoh që burrat kanë gjithë vitin dhe gratë një ditë të vetme. Nga perspektiva ime kjo Ditë shënohet vetëm për të përkujtuar një angazhim dhe sakrificë të grave për barazi, për dekada me radhë, dhe jo thjeshtë si një ditë e vetme në të cilën gruaja çmohet, respektohet dhe ndihet e barabartë me gjininë tjetër. Pra, për mua secila ditë, për secilin njeri, pa dallim gjinie, ka peshën dhe rëndësinë e saj, dhe ashtu duhet të respektohet edhe nga gjinia tjetër çdo ditë.

Ermira Statovci, tetar në Komandën e Doktrinës dhe Trajnimit në Ferizaj

Gazeta Forca Jonë: A e konsideroni profesion të vështirë detyrën e ushtarakes?
Ermira Statovci: Në fillim të karrierës, veçanërisht para se të bëhem pjesë e FSK-së, profesionin e ushtarakes e kam konsideruar jashtëzakonisht të vështirë, ngase nuk kam pasur njohuri për detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e një ushtarakeje. Tani që jam pjesë e FSK-së, jam bindur se ky profesion është i vështirë, por që mund të ushtrohet me sukses, vetëm nëse ke dashuri për punën e ushtarakes dhe t'i kryesh detyrat me përkushtim, të cilat shtrohen para teje, në punën dhe aktivitetet e përditshme.



Gazeta Forca Jonë: Çka do të thotë për ju 8 Marsi nga këndi i ushtarakes?
Ermira Statovci: 8 Marsi, për mua paraqet një kremte kur ne femrat, çfarëdo pune që të kryejmë, duhet t'i sublimojmë rezultatet e arritura, aq më parë, ne që u përkasim profesioneve pak më të veçanta, siç është profesioni i ushtarakes. Unë e pres 8 Marsin me një mburrje të veçantë, sepse unë dhe koleget e mia kemi arritur të dëshmojmë se jemi të afta t'i kryejmë me sukses edhe punët më të ndërlikuara dhe më të vështira, që i përkasin profesionit tonë, për të cilin jemi përcaktuar me dëshirë dhe me vullnet të plotë.

Gazeta Forca Jonë: A arrini t'i kaloni me sukses sfidat gjatë trajnimeve të para dhe tani në shërbim në FSK?
Ermira Statovci: Me një besim të fortë në vetvete, ia kemi dalë, që me sukses t'i kalojë sfidat e mëdha, me të cilat jam ballafaquar në trajnimet bazike, të cilat kanë qenë edhe më të vështirat, me që ishin hapat e mi të parë, në një segment jete, deri atëherë plotësisht të panjohur për mua. Me të njëjtin sukses vazhdoj t'i kalojë edhe sfidat e tashme, meqë jam e vetëdijshme se sa më të suksesshme të jemi ne, bashkë me të gjithë pjesëtarët e tjerë të FSK-së, aq më i suksesshëm do të jetë edhe funksionimi i sistemit mbrojtës të vendit tonë.

Në MFSK përfundoi seminari Forcat e Armatosura në Demokraci



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), zotëri Haki Demolli mirëpriti oficerët gjerman nga "Qendra e Edukimit Qytetar dhe Zhvillimit të Udhëheqjes" (Leadership Development and Civic Education Center), nënkolonel Martin Gerster dhe kapiteni Dirk Peddinghaus, të cilët që nga data 10-12 mars mbajtën në MFSK, seminarin me temë "Forcat e Armatosura në Demokraci". Në fjalën e tij drejtori i Departamentit për Politika dhe Plane në MFSK Faruk Geci vlerësoi se ky trajnim ka qenë i mirëpritur nga pjesëmarrësit e seminarit, sepse ata janë pajisur me informacione dhe përvoja të rëndësishme nga ushtria gjermane. Në seminar morën pjesë 30 pjesëtarë të MFSK-së dhe FSK-së, duke përfshirë këtu zyrtarë të lartë civilë si dhe oficerë komandues nga njësi të ndryshme të FSK-së, të cilët kishin mundësi që gjatë këtyre ditëve, përmes ligjëratave interaktive dhe debateve të shpeshta, të shkëmbejnë idetë dhe përvojat për çështje me interes shumë praktik të drejtimit dhe detyrave që kryejnë në kuadër të institucionit. Të gjithë të pranishmit në fund të trajnimit u certifikuan nga ligjëruesit gjerman. Temat e trajtuara kanë qenë të ndryshme dhe me interes për pjesëmarrësit si: koncepti i zhvillimit të udhëheqjes dhe edukimit civil, komisionari parlamentar për forcat e armatosura, ligji disiplinor, pajtueshmëria e familjes dhe detyrës, udhëheqja e brendshme, të drejtat dhe detyrat e personelit ushtarak, integrimi i forcave ushtarake sipas të drejtës kushtetuese dhe shumë tema tjera interesante dhe me vlerë.



Nënoficerët e FSK-së përfunduan trajnimin Taktikat për njësi të vogla



Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Istog, më 17 mars 2015, u mbajt ceremonia e certifikimit të 44 pjesëtarëve të FSK-së, pas përfundimit të trajnimit ,,Taktikat për njësi të vogla". Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë, kolonel Xhevahir Geci, ushtrues i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), koloneli Muharrem Rrahmani ushtrues i detyrës së komandantit të Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO), shefi i Shtabit të BRSH-së, major Ejup Maqedonci, komandantët e tri batalioneve të Brigadës për Reagim të Shpejtë si dhe oficerë dhe nënoficerë të Shtabit të BRSH-së. Me këtë rast, koloneli Xhevahir Geci duke iu drejtuar të sapo certifikuarve, ndër të tjera tha: Trajnimi"Taktikat për njësi të vogla" ka qenë dhe do të mbetet prioritet sepse është trajnim që ka dhënë fryte pozitive në aspektin e ngritjes profesionale të pjesëtarëve për kryerjen e detyrave në kuadër të misionit aktual dhe për misionin e Forcës sonë, në të ardhmen". Ai, në fund, kërkoi nga të certifikuarit që njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë trajnimit t'i përcjellin te njësitet e tyre, "sepse vetëm kështu, koha dhe mundi i juaj, që keni shpenzuar gjatë këtij trajnimi do të mund të shndërrohej në një veprim në të mirë të vendit tonë"tha kolonel Geci. Trajnimi ,,Taktikat për njësi të vogla" ka filluar më 09 shkurt 2015 dhe ka përfunduar më 13 mars 2015. Kjo ka qenë gjenerata e parë për vitin 2015, kurse e 7-ta me radhë, të cilat janë planifikuar dhe realizuar në Brigadën për Reagim të Shpejtë. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë, pjesëtarë të tri batalioneve të BRSH-së, të Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) dhe njësive tjera të Komandës së Forcave Tokësore (KFT). Gjatë këtij trajnimi, pjesëtarët janë pajisur me njohuri teorike dhe praktike në fusha të ndryshme, ndërsa fokusi kryesor gjatë trajnimi ka qenë ngritja dhe profesionalizimi i pjesëtarëve të BRSH-së dhe njësive tjera të FSK-së. Në fund u ndanë certifikata për të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit, ndërsa për pjesëtarët e dalluar dhe për instruktorët e trajnimit u ndan edhe mirënjohje.

FSK-ja mori pjesë në trajnimin Angazhimi ndaj rrezikut radioaktiv dhe armëve të dëmtimit në masë, në Tiranë

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë, më datë 27 shkurt 2015, u zhvillua ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve në kursin "Angazhimi ndaj rrezikut radioaktiv dhe armëve të dëmtimit në masë" organizuar nga Zyra Amerikane e Bashkëpunimit (ODC) në Tiranë, dhe mbështetur nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FA).
Kursin e mbajtën instruktorët amerikanë të specializuar në këtë fushë, të cilët gjatë katër ditëve, (24-27.02.2015) sa zgjati kursi, mbajtën ligjërata intensive, ku preken temat kryesore rreth përgatitjeve sa më të mira për ekipet e Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe ushtarakëve (5 pjesëtarë) të Kompanisë së Mbrojtjes Kimike Atomike Biologjike (MKABK) të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së. Me rastin e certifikimit, udhëheqësi nga ekipi i ODC-së amerikane, lavdëroi pjesëmarrësit gjatë trajnimit duke u shprehur i gatshëm që të vazhdojnë edhe më tej bashkëpunimin në organizimin edhe kryerjen e kurseve tjera.
Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë përshëndeti atasheu ushtarak i Shqipërisë për Kosovë, kolonel Fiqri Hoxha. Ai falënderoj ODC-në, për organizimin e këtij kursi, duke u shprehur i bindur se ky trajnim do jetë shumë i vlefshëm për Forcat e Armatosura Shqiptare si dhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
Ndërsa, në emër të FSK-së, nënkolonel Enver Dugolli, atashe i Kosovës në Tiranë, uroi të gjithë kursantët për përkushtimin e tyre në marrjen e njohurive të reja, dhe njëherësh kërkoi nga ta, që mësimet e marra t'i aplikojnë me sukses në njësitë ku veprojnë, duke ndarë njohuritë e fituara edhe me kolegët e tyre. Nënkolonel Dugolli në mënyrë të veçantë falënderoi ekipin e instruktorëve amerikanë dhe koordinatorët e këtij ekipi, të cilët mundësuan pjesëmarrjen e pjesëtareve të FSK-së në këtë trajnim, e që është me interes të veçantë për pjesëtarët e MKABK-së. Në ceremoni mori pjesë edhe shefi i Shtabit të Forcave Tokësore të Shqipërisë, koloneli Tonin Marku, si dhe ushtarakë të lartë të FA-së.



FSK-ja filloi operacionet e çminimit

Kompania e Deminimit (KD) e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), më 30 mars 2015, ka filluar operacionet për çminimin humanitar dhe pastrimin e fushëbetejave (BAC) në tri lokacione të ndryshme, ku është paraparë fillimi si dhe vazhdimi i punës për pastrimin e fushave të minuara dhe fushëbetejave. Kompania e Deminimit, sipas planit operacional ka filluar punën dhe aktivitetet me tri ekipe deminerësh në terren, në këto lokacione: në Zagerm të Komunës së Pejës dhe në Ferizaj, do të kryhet pastrimi i fushëbetejave (BAC), ndërsa në Seqishtë të Komunës së Hanit të Elezit do të kryhen operacionet e deminimit humanitar. Kompania e Deminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile e FSK-së ka kryer të gjitha përgatitjet e duhura, dhe operacionet e deminimit pritet që do të shkojnë mbarë edhe këtë vit. Gjatë sezonit dimëror janë zhvilluar trajnime rifreskuese si dhe përgatitjet tjera të nevojshme në mënyrë që sezoni i deminimit 2015, pra nga 30 marsi deri më 30 nëntor të zhvillohet me sukses. Kompania e Deminimit gjatë sezonit dimëror, atëherë kur kushtet atmosferike nuk lejojnë operacionet në terren, vazhdimisht, për çdo vit angazhohet në fushatë vetëdijesimi për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera eksplozive të pashpërthyera.

Certifikohen kursantët e MKAB-së dhe të Logjistikës

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në Ferizaj, më 20 mars 2015, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, pas përfundimit me sukses të dy kurseve; të Mbrojtjes Kimike Atomike Biologjike (MKAB) dhe kursit të Logjistikës. Me këtë rast, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Enver Cikaqi tha se: "Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) çdo ditë e më shumë po arrin shkallë më të lartë të profesionalizmit dhe kjo është e mirë, që, ne po realizojmë trajnime me pjesëtarët e njësive të ndryshme të FSK-së, ku njohuritë e mësuara këtu po i shpërndajnë në njësitë dhe kështu po krijojmë një metodë unike të punës në praktikë. Falë angazhimit të dyanshëm edhe të instruktorëve, por edhe të pjesëtarëve që e kanë ndjekur trajnimin, rezultatet janë të larta dhe kjo na bënë të ndihemi krenar dhe të përkushtohemi edhe më shumë në të ardhmen me gjeneratat e reja, por edhe të kurseve tjera. Trajnimi i MKAB-së është një prej trajnimeve më të rëndësishme në FSK dhe mua më gëzon fakti se pjesëtarët tanë kanë bërë një punë profesionale. Ndërsa, sa i përket kursit të Logjistikës është një kurs të cilin duhet ta kenë të kryer sa më shumë pjesëtarë të FSK-së, me qëllim që të dihet se sa është i rëndësishëm dhe sa krijon lehtësi në realizimin e detyrave pas përfundimit të këtij trajnimi". Qendra Specialistike e Stërvitjes (QSS) organizoi dhe realizoi këto kurse për pjesëtarët e FSK-së që nga viti 2009, fillimisht me ekipet e NATO-s, dhe tashmë ka përshtatur këto kurse për nevoja të FSK-së, si dhe ka përgatitur kuadrin profesional për realizimin e tyre. Për llojin e kursit, rolin dhe rëndësinë që kanë këto kurse në FSK, foli komandanti i QSS-së major Feriz Trezhnjeva i cili tha: "Tani, pas realizimit në mënyrë profesionale të këtyre kurseve, kemi një staf të përgatitur. Instruktorët tanë kanë dhënë maksimumin nga vetja për të pasur rezultate të cilat sot po i prezantojmë, ndërsa përkushtimi i pjesëtarëve në këto kurse ka qenë jashtëzakonisht i lartë për çka i përgëzoi për pjesëmarrje aktive".



Të dyja kurset kanë zgjatur katër javë, ndërsa pjesëtarët e FSK-së, kanë arritur që me sukses të përfundojnë këto kurse duke treguar rezultate dhe përkushtim të lartë. E veçanta e këtyre kurseve ka qenë se janë realizuar në mënyrë të kombinuar teori dhe praktikë, ku në pjesën dërmuese të trajnimit është përdorur metoda praktike. Në bazë të rezultateve të testit final ky trajnim ka rezultuar të jetë mjaft i suksesshëm.

Nga MKAB kursin e kanë ndjekur 14 pjesëtarë, ndërsa nga Logjistika 13 pjesëtarë. Në fund për të gjithë kursantet u ndanë certifikata.

Në kazermën "Adem Jashari" përfundoi seminari Zhvillimi i nënoficerëve shtabor



Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, përkatësisht në Batalionin e Xhenios më 27 mars 2015, u mbajt ceremonia e certifikimit të 42 pjesëtarëve të cilët për pesë ditë ndoqën seminarin, "Zhvillimi i nënoficerëve shtabor " i cili u mbajt nga ekipi i instruktorëve të Gardës Kombëtare të Ajovës. Me këtë rast, rreshter majori i FSK-së, Genc Metaj u shpreh mjaft i kënaqur me rezultatet e këtij trajnimi. Ai nder të tjera tha: "Po ndihem mjaft mirë si krye- nënoficer i FSK-së, pasi që, nga ekipi i instruktorëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Gardës Kombëtare të Ajovës kemi fituar njohuri dhe përvoja që do na ndihmojnë shumë në të ardhmen". Rreshter majori Metaj falënderoi në veçanti instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës për mbështetjen dhe kontributin e tyre për FSK-në. Ndërsa, Majori Obrecht, nga ekipi i Gardës Kombëtare të Ajovës , tha se ndihet i lumtur me suksesin e treguar të pjesëtarëve të FSK-së. " Ishte privilegj dhe krenari të jem me ju përgjatë këtyre pesë ditëve, dhe ju falënderoj për kontributin dhe angazhimin që keni treguar gjatë tërë kohës"- tha në fund majori Obrecht.

Në fund të ceremonisë u ndanë certifikata për të gjithë kursantet, ndërsa për instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës u ndanë mirënjohje.

Batalionet e Reagimit të Shpejtë realizuan marshin kondicional

Batalioni i Dytë dhe i Tretë i Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, më 4 mars 2015, realizuan me sukses marshimin kondicional në shtigje të gjata me emrin e koduar: ,,Dimri 2015" dhe ,,Marshimi për mision". Aktivitetet janë realizuar sipas planit vjetor të aktiviteteve dhe trajnimeve të Batalioneve 2 dhe 3 të BRSH-së. Qëllimi i këtij marshimi ishte testimi dhe mbajtja e kondicionit fizik të pjesëtarëve të BRSH-së, në distanca të gjata. Në këto marshime kanë marë pjesë të gjithë pjesëtarët e Batalionit të Dytë dhe të Tretë të BRSH-së, përfshirë edhe stafin komandues. Në marshim mori pjesë edhe ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci. Kolonel Geci i ka përgëzuar pjesëtarët e Batalionit të Tretë për suksesin dhe organizimin e marshit 2015. Marshimi ka përfunduar me kohë dhe pa asnjë pengesë. Ky fakt dëshmon se pjesëtarët e Batalionit të Dytë dhe Tretë të Reagimit të Shpejtë posedojnë një përgatitje të lartë fizike dhe janë të gatshëm në përballimin e çfarëdo detyre dhe sfide e cila u caktohet. Realizimi i marshimeve ka qenë i bazuar në Procedurat Standarde Operactive (PSO), dhe realizimi i tij me sukses ka arritur objektivat e parapara.



Nxënësit e "Shkollës së Gjelbër" vizituan kazermën "Adem Jashari"

Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, më 30 mars 2015, e vizituan nxënësit (120 nxënës) e klasave të dyta dhe të treta të shkollës së mesme të ulët "Shkolla e Gjelbër" nga Prishtina. Nxënësit e kësaj shkolle u pritën nga oficerë të FSK-së, të cilët më pastaj i shoqëruan nxënësit gjatë vizitave në ambientet e kazermës "Adem Jashari". Gjatë kësaj vizite, nxënësit dhe arsimtarët e tyre përveç që u njoftuan me Forcën e Sigurisë së Kosovës, ata në amfiteatrin e Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO), përcollën edhe një film dokumentar të FSK-së, rreth aktiviteteve, ushtrimeve dhe trajnimeve të ndryshme të



pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe u njoftuan më hollësisht rreth rregullave ushtarake nga majori Mehdi Maloku, zyrtar i Zyrës për Bashkëpunim Civilo- Ushtarak në Brigadën e Mbështetjes Operacionale. Nxënësit e" Shkollës së Gjelbër", shprehen mjaft interesim për të mësuar sa më shumë për FSK-në, kjo u vërejt edhe në pyetjet e tyre, të cilave iu përgjigj majori Mehdi Maloku. Ndërsa, Agim Kosumi mësues i klasës së tretë, u shpreh se ndjehet i kënaqur nga kjo vizitë " Ishte një vizitë mjaft e mirë, çdo gjë ishte e organizuar ashtu siç duhet , fëmijët u ndjenë të lumtur pas kontaktit më pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjithashtu edhe ne personeli jemi mjaft të kënaqur nga gjithçka që pamë sot, në kazermën "Adem Jashari", këtu në Prishtinë. Në fund, nxënësit dhe arsimtarët e tyre, gjithashtu, vizituan edhe Bibliotekën e FSK-së, ku patën rastin të shohin libra të autorëve të ndryshëm, me ç 'rast ata u treguan mjaft kureshtar të dinë më shumë rreth literaturës si dhe leximit të librave nga ushtarët e FSK-së.

FORCA JONË

* * * Viti IV • Nr. 34 • Maj 2015 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i MFSK-së, Haki Demolli, në Panairin Ndërkombëtar të Armëve në Kroaci

Me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Kroacisë, Ante Kotromanovic, në hapjen solemne të Panairit Ushtarak Ndërkombëtar, që u mbajt në Split, mori pjesë ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës Haki Demolli me një delegacion të FSK-së. Hapja solemne e Panairit të industrisë ushtarake, ushtrimi detar dhe konferenca u mbajtë në arena Spaladium të Splitit, ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, Ante Kotromanoviq, shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjenerali Drago Lovriq, ministri i FSK-së, Haki Demolli, ministri i Mbrojtjes i Bosnjës dhe Hercegovinës, ministri i Sllovakisë si dhe shumë delegacione ushtarake të ushtrive të rajonit dhe botës. Gjatë mbajtjes së panairit të armëve në



Split, u mbajt edhe një demonstrim ushtarak i Forcave të Armatosura të Kroacisë, me pjesëmarrjen e forcave detare, ajrore etj. Ekspozita e industrisë ushtarake u mbajt nën patronazhin e Qeverisë së Kroacisë, ku morën pjesë më shumë se 119 kompani vendore, rajoni dhe bota, organizuar nga "TNT ProductionInc" nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjatë qëndrimit në Kroaci, ministri Demolli u takua me ministrin e Mbrojtjes së Kroacisë, Ante Kotromanoviq, si dhe me personalitete civile dhe ushtarake të shteteve pjesëmarrëse në Panairin Ndërkombëtar të Armëve në Split. Panairi qëndroi i hapur për tri ditë rresht, ku vizitorët patën mundësi të njihen me të arriturat e fundit në zhvillimin e pajisjeve ushtarake dhe armëve më moderne.

Konferenca e bashkëpunimit ndërkombëtar "FSK dhe partnerët"

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), më 28-29 prill u mbajt konferenca dy ditore, "FSK dhe partnerët", me organizim të Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Siguri të MFSK-së, në të cilën morën pjesë; ministri i MFSK-së, Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Bashkim Jashari, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtori për Politika dhe Plane Faruk Geci, shefi i Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në (NLAT), gjeneral brigade Werner Hauman, atashetë ushtarakë të vendeve si; Republika e Shqipërisë, Kroacisë, SHBA-ve, Turqisë, Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar, Italisë dhe pjesëmarrës tjerë nga fusha e sigurisë, qoftë të misioneve ndërkombëtare dhe të MFSK-së dhe FSK-së.

Qëllimi i konferencës së përbashkët "FSK dhe partnerët", është rritja e ndërsjellë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes të partnerëve, po ashtu edhe ekipet këshilluese të NATO-s, për Ministrinë (NAT) dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s, për FSK-në (NLAT), si organizma mbështetës të Ministrisë së FSK-së dhe të FSK-së.

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, pasi shpalli të hapura punimet e konferencës "FSK dhe partnerët" tha se është një vërtetë e pranuar gjerësisht, se FSK-ja paraqet një tregim të suksesit në Republikën e Kosovës dhe për këtë opinion të krijuar në vendin tonë lidhur me FSK-në, një meritë e madhe i takon mbështetjes së ofruar nga ju si partnerë, çoftë përmes ndihmës së drejtpërdrejt dypalëshe, e po ashtu edhe përmes mbështetjes profesionale siç janë ekipet këshilluese të NATO-s për Ministrinë (NAT) dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK- në (NLAT), apo edhe përmes formave të tjera të përkrahjes.

Në vazhdim ministri Demolli tha gjithashtu se: "Takimet e këtilla, sikurse kjo konferencë janë të vlefshëm për koordinim dhe mbështetjen e mëtutjeshme të FSK-së. " Në fund të fjalës së tij ministri Demolli tha se duke pasur parasysh procesin në të cilin ndodhemi është më se e nevojshme që të kemi një harmonizim të veprimeve me qëllim që mbështetja e vendeve tuaja të jetë adekuate për fushat e caktuara, e ku përfituesi kryesor do



jemi ne si Ministri e FSK-së.

Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se e vlerësojmë lartë gatishmërinë e vendeve partnere dhe vendeve pjesëmarrëse në konferencë, e gjithashtu gatishmërinë e shprehur në vazhdimësi për të përkrahur FSK-në në mirëmbajtjen e kapaciteteve themelore, si dhe mbështetjen që vendet tuaja kanë dhënë për FSK-në. Më tej gjeneral Rama shtoj : "Siç dihet FSK-ja është duke punuar ngushtë me partnerët në përgatitjet për zbatimin e rekomandimeve të Rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë e cila si e tillë paraqet një sfidë në vete. " Përgatitja për zbatimin e rekomandimeve dhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forcën e ardhshme do të bëhet padyshim në bashkërendim të ngushtë me të gjithë partnerët tanë, theksoi komandanti i FSK-së.

Në vazhdim të konferencës "FSK dhe partnerët" u paraqit kolonel Bashkim Shillova, shef i Sektorit të Operativës dhe Trajnimit në Komandën e Forcave Tokësore (KFT) të FSK-së, i cili paraqiti temën: "Programi i punës së FSK-së dhe NLAT-it për vitin 2015", pastaj kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë për FSK, i cili referoi për temën: " FSK dhe bashkëpunimi me partnerët".

Konferenca vazhdon punimet edhe nesër, me paraqitjet e oficerëve të shumë vendeve pjesëmarrëse, ndërsa mbyll punimet në orët e pasdites. Kjo është konferenca e dytë e këtij lloji, e para është mbajtur në vitin 2014.

Ministri dhe Komandanti i FSK-së takuan ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar

Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën më 27 prill 2015, në takime të ndara ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovës, z. Ruairi O'Connell. Ministri i FSK-së Haki Demolli i shoqëruar edhe nga zëvendësministri Fadil Gashi, priti në takim ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar zotin Ruairi O'Connell i cili shoqërohej edhe nga atasheu ushtarak i Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, nënkolonel Richard Parry, dhe drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s (EKN) në MFSK, zoti Dominic Braitwait, Ministri Demolli pas urimit për emërimin në detyrën e ambasadorit në Kosovë, zotit Ruairi O'Connell i shprehi falënderimet për bashkëpunimin e thellë dhe dinamik që ka ekzistuar në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, duke vlerësuar lartë ndihmën e madhe që është dhënë në trajnimin dhe shkollimin e oficerëve të lartë të FSK-së në akademitë ushtarake elitare të Mbretërisë së Bashkuar si dhe me dërgimin e grupeve të instruktorëve ushtarak në Kosovë për të bashkëpunuar me FSK-në. Gëzon fakti se i gjithë ky bashkëpunim zhvillohet mbi Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar të nënshkruar që në vitin 2009, e që ishte memorandumi i parë i bashkëpunimit të MFSK-së me një Ministri të Mbrojtjes. Po ashtu ministri Demolli e njoftoi ambasadorin edhe mbi zhvillimet e procesit për transformim e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK), si dhe veprimet e kryera nga MFSK deri me sot që janë të nevojshme për këtë transformim, me objektiv të përhershëm për anëtarësim në NATO. Nga ana e tij ambasadori Ruairi O'Connell, shprehi gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin. Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama në takimin që pati me ambasadorin Ruairi O'Connell, fillimisht e uroi për emërimin në detyrën e re të ambasadorit të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë. Komandant Rama e njoftoi ambasadorin nga Mbretëria e Bashkuar për fazën e aktiviteteve të FSK-së, bashkëpunimin me NATO-n dhe bashkëpunimin e mirë me ushtritë e shteteve të rajonit. Ai falënderoi kontributin e Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar në trajnimin e oficerëve dhe ushtarëve të FSK-së, qoftë përmes trajnimeve në Mbretërinë e Bashkuar, qoftë përmes instruktorëve që vijnë në FSK, dhe sidomos ai çmoi lartë pjesëmarrjen në ushtrime fushore të përbashkëta. Komandant Rama



po ashtu foli edhe për përgatitjet dhe planifikimet e kryera për nevojat e transformimit të FSK-së në FAK, duke u angazhuar çdo herë se FAK do të jenë forcë për të mirë dhe në shërbim të sigurisë së rajonit dhe më gjerë. Nga ana e tij ambasadori Ruairi O'Connell përgëzoi komandant Ramën për arritjet e deritashme në ngritjen e strukturës së FSK-së. Ai e vlerësoi si një e arritur e përbashkët, që Kosova nga konsumues i sigurisë po transformohet në eksportues të sigurisë përmes bashkëpunimit me ushtritë e rajonit dhe me NATO-n

Ministria e FSK-së dhe Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë me projekte të përbashkëta

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Ministrisë së Mbrojtjes të Norvegjisë (CIDS), më 21 prill 2015, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) lansuan dy projekte: "Mbështetja për sistemin e menaxhimit të resurseve njerëzore në MFSK" dhe "Forcimi i integritetit të kornizës punuese në MFSK". Qëllimi i këtyre projekteve është të mbështesë MFSK-së në një periudhë kohore prej tri vitesh, si dhe të kontribuojë në krijimin e një integriteti publik më të mirë të kornizës punuese, duke reduktuar rreziqet institucionale të korrupsionit e promovimit dhe profesionalizmit meritokratik në MFSK. Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë përmes CIDS, ka premtuar angazhimin e saj për të mbështetur qeverisjen demokratike dhe mekanizmat e kontrollit të MFSK-së. Në fjalën e tij tematike, Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj tha: "Përmes këtyre projekteve, po hapim një kapitull të bashkëpunimit bilateral në mes të dy ministrive, Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së



Norvegjisë. Fjala është për dy projektet e iniciuara bashkë me Qendrën e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë që kanë të bëjnë me fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në MFSK dhe ngritjen e integritetit në MFSK. Edhe pse dy projekte të ndara, që të dyja janë komplementare sepse për qëllim final kanë ngritjen e kontrollit civil demokratik në MFSK dhe fuqizimin e parimeve të qeverisjes së mirë. Fakti që dy projektet janë tre-vjeçare, tregon angazhimin tonë të përbashkët me Qendrën e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë.
Kontributi i Norvegjisë në reformën e sektorit të mbrojtës dhe sigurisë është shumë i nevojshëm dhe shumë i mirëseardhur për MFSK-në. Ne presim që kjo mbështetje e çmuar do të bëhet formale nëpërmjet një marrëveshje bashkëpunimi ndërshtetërore, përkatësisht ndërmjet MFSK-së dhe MM së Norvegjisë. Kësisoj do të forconim edhe më shumë karakterin e bashkëpunimit". Gjithashtu, Sekretari Sylaj u shpreh i bindur në thellimin e bashkëpunimit në mes të këtyre dy ministrive "Ne jemi të bindur që përvoja juaj në funksion të qeverisjes së mirë do të jetë tejet e nevojshme për konsolidimin e MFSK-së dhe përqafimin e kritereve të NATO-së. Ai shprehi përkushtimin e MFSK që të jetë shumë bashkëpunues dhe të ofrojë gjithë gatishmërinë me qëllim të arritjes së objektivave të këtyre projekteve. Ne do të punojmë në masa të veçanta kundër të gjitha dukurive negative duke marrë për bazë parimet e definuara me programin e NATO-s, BE-së dhe SHBA-ve, për ngritjen e Integritetit (Building Integrity Programme). Për këtë u jemi mirënjohës Qendrës së Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë për këtë mbështetje", përfundoi fjalën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj.
Para të pranishmëve foli edhe zëvendësministri i MFSK-së, z. Fadil Gashi i cili tha se iniciativat që kanë për qëllim ngritjen e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërshtetëror, do t'i shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë fuqizimit të kontrollit civil demokratik në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
Ndërsa ambasadori i Norvegjisë Jan Braathu tha se integriteti dhe qeverisja e mirë janë të rëndësishme për të gjitha vendet. Korrupsioni ndikon në tërë shoqërinë dhe në fund të fundit vetë shtetin. Pjesëmarrja e Kosovës në Programin "Building Integrity" është shumë e rëndësishme. Ai gjithashtu sjell Kosovën më afër procesit të saj të integrimit në NATO. Gjithashtu me një fjalë tematike u inkuadrua z. Svein Eriksen (Center for Integrity). Prezantimin e këtyre projekteve "Mbështetje personelit dhe ngritja e integritetit në MFSK" e bëri Florian Qehaja udhëheqës i ekipit për Kosovë.
Në takimin ishin prezentë: Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, zëvendësministri i MFSK-së, z. Fadil Gashi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralbrigade Zymer Halimi, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane në MFSK, Faruk Geci, ambasadori i Norvegjisë, Jan Braathu, Svein Eriksen(Center for Integrity), përfaqësues të ambasadave në Kosovë, atashe ushtarak të ambasadave të akredituara në Kosovë, drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s, (NAT) Dominic-Haydn Braithwaite, zyrtar të Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NLAT), KFOR-it, këshilltarja e MODA-së, znj. Meg Ardner, zyrtarë dhe oficerë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së.

Komandanti i FSK-së mori pjesë në shënimin e 100-vjetorit të Betejës së Çanakalasë në Turqi


Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama me ftesë të Qeverisë së Republikës së Turqisë, më 28 prill mori pjesë në aktivitetet për shënimin e 100 vjetorit të Betejës së Çanakalasë, e njohur si Fushata Luftarake e Galipolit, betejë e zhvilluar gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore. Gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku edhe me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçin si dhe ambasadorin e Kosovës në Republikën e Turqisë Avni Spahiun morën pjesë në ceremoninë e zhvilluar në Çanakala, ku përveç homazheve dhe ceremonive tjera në kujtim të Betejës, gjeneral Rama zhvilloi edhe disa takime me disa prej homologëve të tij, pjesëmarrës në ceremoni. Gjatë qëndrimit në Turqi, gjeneral Rrahman Rama ishte pjesë edhe e Samitit të Paqes, në të cilin morën pjesë edhe shumë personalitete politike e ushtarake si nga Australia, Zelanda e Re, Mbretëria e Bashkuar, Iraku, gjithashtu vendet e Ballkanit etj.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama vizitoi KDS-në



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama i shoqëruar nga këshilltari i tij nga Britania e Madhe, nënkolonel David Jones dhe ndihmës atasheu ushtarak i ambasadës Amerikane në Prishtinë, major Thomas Melton, më 15 prill 2015, vizituan Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj. Gjatë vizitës ata u takuan me komandantin e KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, me të cilin diskutuan për trajnimet të cilat janë duke u realizuar në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe vizituan rekrutët në Kursin Bazik.
Gjeneral Rama fillimisht i përgëzoi rekrutët e kursit bazik për përzgjedhjen e tyre që të jenë pjesë e FSK-së. Ai duke bashkëbiseduar me ta ndër të tjera iu tha se të qenit pjesë e FSK-së është nder për ju, por edhe krenari për familjet e juaja, sepse kjo është një nga mënyrat më të mira për t'i shërbyer vendit". Ju e keni rastin t'i kontribuoni vendit tuaj, unë jam njoftuar nga komandanti juaj se ju jeni duke treguar përkushtim të lartë, në përpjekjet tuaja për të arritur rezultate sa më të larta dhe kjo na bënë të mburremi me punën e instruktorëve, me përkushtimin tuaj dhe angazhimin e tërë stafit që kursi të përfundojë me sa më shumë sukses".
KOMFSK bisedoi edhe me instruktorët me të cilët diskutoi për sfidat e mundshme, por edhe kërkoi nga ta që të vazhdojnë me përkushtimin e njëjtë deri në finalizimin e këtij programi.
Gjeneral Rama e pa nga afër demonstrimin e aftësive të rekrutëve në pjesën praktike të trajnimeve, pjesë e planit të stërvitjes në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, për të cilin tha se e gëzon fakti që rekrutët kanë arritur ta kuptojnë dhe ta demonstrojnë një plan taktik për një periudhë relativisht të shkurtër, e cila pa përkushtimin e rekrutëve dhe angazhimin e instruktorëve nuk do të ishte e mundur të ndodh.

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së nderoi me mirënjohje këshilltaren e NATO-s



Zonja Anda Kemme ka qenë këshilltare ligjore në Ekipin Këshillues të NATO-s, e cila ka mbështetur Departamentin Ligjor në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK). Znj. Kemme ka ardhur nga Ministria e Mbrojtjes së Letonisë dhe ka shërbyer si këshilltare ligjore për 2 vite në MFSK. Me rastin e përfundimit të mandatit të saj, në një ceremoni modeste, më 23 prill, znj. Kemme është pritur nga Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj. Në takimi ishin të pranishëm edhe drejtoresha e Departamentit Ligjor, znj. Krenare Sogojeva-Dërmaku, shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s, z. Dominic Braitwait dhe Vineta Kleine këshilltare e Ekipit Këshillues të NATO-s. Me këtë rast, z. Sylaj falënderoi znj. Kemme për kontributin e saj dhënë Departamentit Ligjor të MFSK-së, si këshilltare ligjore. Me këtë rast, z. Sylaj në emër të ministrit të FSK-së, z. Demolli e nderoi me mirënjohje znj. Kemme për punën dhe kontributin e dhënë gjatë kohës sa ajo ka shërbyer në MFSK. Znj. Kemme e falënderoi z. Sylaj, për pritjen që i është bërë, për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që ka pasur në Ministrinë e FSK-së dhe Departamentin Ligjor, si dhe për Mirënjohjen që iu dha.

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës u mbajt "Java e NATO-s"




Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, nën organizimin e Asociacionit të Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës (KYATA) së bashku me Departamentin për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Departamentin për Siguri dhe Bashkëpunim të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 14 prill u mbajt "Java e NATO-s".
Në seminarin "Java e NATO-s dhe Simulimi i Këshillit Atlantik" morën pjesë studentë -përfaqësues të SHBA-ve, Turqisë, Shqipërisë, Maqedonisë, Italisë, Bullgarisë, Serbisë, etj. Kryetari i Asociacioni të Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës "KYATA" z. Besim Salihua tha: "Ne në takimin e sotëm, që është vazhdim i aktiviteteve tona, e simuluam Këshillin e NATO-s dhe e trajtuam krizën e Ukrainës si dhe pushtimin e saj nga Rusia.
Punimet e seminarit i përshëndetën gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione, z. Faruk Geci, drejtor i Departamentit për Politika dhe Plane si dhe Dominik Braitwait, shef i Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK (NLAT). Të gjithë pjesëmarrësit e seminarit kontribuuan me fjalimet e tyre që të mbahet me sukses "Java e NATO-s".

Njësia e Kërkim-Shpëtimit e FSK-së gjeti trupin e Sead Alushit në lumin Ibër



Ekipi i kërkim-shpëtim në ujëra i Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, pas 19 ditësh të operacionit të kërkimeve në lumin Ibër të Mitrovicës, më 28 prill 2015, rreth orës 13. 00 e gjeti trupin e pajetë të Sead Alushit 17 vjeç, nga fshati Suhadoll i Mitrovicës. Seadi, më 10 prill 2015, tek sa po tentonte ta kalonte lumin Ibër ishte mbytur.
Gjatë 19 ditëve të kërkimit, FSK-ja kishte angazhuar çdo ditë një ekip profesionistësh në ujëra prej 17 deri 40 pjesëtarë (varësisht prej rrethanave) me 4 automjete, dy barka si dhe pajisjet specialistike për kërkim-shpëtim në ujëra.
Ekipi i FSK-së, trupin e pajetë të Sead Alushit e ka gjetur në lumin Ibër, vendin Rudare të Zveçanit, rreth orës 13. 00, ndërsa më pastaj është bërë identifikimi i tij, nga ekipi i mjekësisë ligjore.
Gjatë operacionit ekipin e kërkim-shpëtimit të FSK-së në ujëra, i ka vizituar komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile kolonel Shaip Haziri, zyrtarë të Ministrisë së FSK-së dhe oficerë të FSK-së, në përkrahje të kërkimit të trupit të Sead Alushit.
Gjatë kohës së zhvillimit të operacionit, ekipi i kërkim-shpëtimit të FSK-së, ka gjetur në lumin Ibër edhe një trup të pajetë të një qytetari të moshës mbi 60 vjeç, të komunitetit serb.
Ekipi i kërkim-shpëtimit të FSK-së, gjatë tërë kohës së operacionit u përkrah dhe pati një bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in, Policinë e Kosovës, udhëheqjen e komunave, qytetarët dhe strukturat tjera komunale.




FSK-ja në shënimin e Ditës së Tokës



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me kryetarin e Komunës së Kastriotit, z. Xhafer Gashi, zëvendësministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferat Shala dhe me bashkëpunëtorë vizituan fshatin Plemetin të Komunës së Kastriotit, ku në mënyrë simbolike filluan aksionin për pastrimin e mjedisit, me rastin e shënimit të "Ditës së Tokës" 22 prillit. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka përgëzuar pjesëtarët e xhenios të FSK-së, të cilët janë angazhuar në pastrimin e mjedisit në fshatit Plemetin të banuar edhe me pjesëtarë të komunitetit serbë, romë etj. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama tha: "Ne si FSK, e kemi dëshmuar dhe e dëshmojmë për çdo ditë që jemi në shërbim të qytetarëve pa dallim etnie. Ne do të vazhdojmë t'i përkrahemi institucionet, si ato komunale ashtu dhe ato qendrore, si dhe organizatat e ndryshme joqeveritare, por edhe vetë komunitetin. Është një gjë e mirë që ne, sadopak me mundësitë tona që i kemi, të krijojmë kushte sa më të mira, sepse ambienti është i rëndësisë së veçantë për shëndetin e të gjithë qytetarëve" tha në fund komandanti i FSK-së gjeneral Rama.
Ndërsa, zëvendësministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferat Shala, shtoi "Sot jemi në vigjilje të Ditës Botërore të Tokës e cila shënohet në mbarë rruzullin tokësor. Praktikisht janë sfidat më të mëdha me të cilat shoqëria njerëzore ballafaqohet, në njërën anë me degradimet, eksploatimin dhe shfrytëzimin e resurseve të saj, dhe në anën tjetër me sfidën e menaxhimit të gjithë nivelit shoqëror për përmirësimin e degradimeve, qoftë nga e kaluara, qoftë të tanishme". FSK-ja për pastrimin e mjediseve të fshatrave Plemetin dhe Babin Most ka angazhuar në terren 2 ngarkues dhe gjashtë kamionë me gjithsej 12 pjesëtarë të FSK-së, të cilët kanë bërë pastrimin e dy vendeve të mbeturinave. Ky aktivitet është realizuar edhe në bashkëpunim me Komunën e Kastriotit. Kryetari i Komunës së Kastriotit falënderoi pjesëtarët e FSK-së, të cilët me angazhimin e tyre ndihmuan në pastrimin e mjediseve të kësaj komune.



Kadetët e FSK-së me sukses realizuan ushtrimin fushor "Pëllumbi 2"





Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë së Kosovës, prej datës 03-07. 04. 2015, ka realizuar ushtrimin fushor "Pëllumbi 2" në Zhegoc të Gjilanit.

Qëllimi i ushtrimit ishte përgatitja taktike në operacionet urbane ofensive dhe mbrojtëse si dhe testimi i gatishmërisë fizike dhe psikike të kadetëve. Gjatë realizimit të ushtrimit fushor, "Pëllumbi 2" kadetët e QSU-së, u përballen edhe me temat tjera, si operacionet urbane ofensive dhe mbrojtëse, evakuimi i të lënduarve nga fushëbeteja, navigimi tokësor ditën dhe natën, patrullimet, reagimi në kontakt etj. Për të përcjellë nga afër ushtrimin fushor të koduar me emrin "Pëllumbi 2" të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare, ishin edhe atasheu ushtarak i Mbrojtjes së SHBA-ve, koloneli Chud Butts, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Kampit Bondsteel, koloneli Clinton Backer dhe oficerë të lartë të FSK-së. Me këtë rast, paraqitjen e kadetëve të FSK-së e vlerësuan lartë, koloneli Butts, gjenerali Cikaqi dhe komandanti i QSU-së, kapiten Avni Kiçina i cili pos tjerash tha se "është arritur tërësisht qëllimi dhe objektivat e ushtrimit për përgatitjen e kadetëve të QSU-së, para ushtrimit final që do të mbahet në përfundim të vitit akademik".

Ndërsa, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi dhe atashe ushtarak i Mbrojtjes i SHBA-ve, kolonel Butts u ndanë të kënaqur me përgatitjen dhe paraqitjen e shkëlqyeshme të kadetëve të FSK-së, gjatë mbajtjes të ushtrimit fushor "Pëllumbi 2". Koloneli amerikan Butts e vlerësoi lart angazhimin e instruktorëve dhe kadetëve të QSU-së, për punën e tyre të palodhshme gjatë përgatitjes së oficerëve të FSK-së.

Betohen 155 ushtarët e rinj të FSK-së, gjenerata e parë 2015

Sot në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të 155 rekrutëve të rinj të FSK-së, gjenerata e parë 2015, të cilët për nëntë javë trajnimi intensiv e përmbyllin me sukses Kursin Bazik dhe treguan përkushtim të lartë në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të dala nga programi i shkollës. Ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli duke ju drejtuar rekrutëve-ushtarëve të rinj, shtoi: "Nuk ka mision më të shenjtë, se të jesh ushtarë në shërbim të mbrojtjes së lirisë dhe demokracisë, vlera dhe parime këto për të cilat gjenerata të tëra kanë sakrifikuar. Të qenit pjesëtarë të FSK-së është kënaqësi, detyrë dhe nderë për ju, që të jeni në shërbim të sigurisë, duke qenë të gatshëm në çdo moment për t'u aktivizuar në detyra dhe misione që janë në të mirë të sigurisë së shtetit të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve, pa dallime kombi, race apo gjinie". Ministri Demolli falënderoi stafin trajnues të KDS-së, për angazhimin e tyre të pakursyer në realizimin e këtij trajnimi, për të shtruar: "Niveli i trajnimit tuaj bazik me standarde të ushtrive më moderne, është një shembull i qartë i zhvillimit dhe progresit që po e bën FSK-ja në profesionalizimin e saj. Ju po certifikoheni në një moment të rëndësishëm të ndërtimit kapaciteteve mbrojtëse të shtetit tonë. Në kohën kur janë bërë planifikimet dhe përgatitjet e duhura për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK). Ky transformim sjell mision dhe perspektivë të re për të gjithë, por veçanërisht hapë mundësi më të mëdha për zhvillimin e karrierës tuaj ushtarake. Prandaj kjo mundësi e re duhet t'ju motivojë edhe më shumë për realizimin e detyrave që dalin para jush gjatë kryerjes së shërbimit në FSK". Në fund, ministri Demolli uroi ushtarët e rinj, me dëshirën për të treguar suksese në detyrat e reja dhe njëherësh kërkoi angazhimin e tyre në stërvitje, në kuadër të strukturës së FSK-së, me qëllim të realizimit të objektivave të deklaruar për ta bërë FSK-në, forcë profesionale dhe efikase të sigurisë në të mirë të Kosovës dhe gjithë qytetarëve të saj. Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama në fjalën e tij, tha: "Ky është vetëm fillimi i rrugëtimit tuaj në një profesion fisnik. Gjatë karrierës tuaj, ju do të ballafaqoheni me sfida të ndryshme. Por, gjithmonë mbani në mend, që ne jemi në shërbim të vendit atëherë kur vendi ka nevojë më së shumti për ne. FSK-ja është forcë e besueshme, profesionale dhe forcë për të mirë të vendit dhe rajonit. FSK-ja është duke vepruar në gjithë territorin e vendit duke i mbështetur autoritetet civile dhe qytetarët e Kosovës pa dallime. FSK-ja është duke marrë pjesë në ushtrimet regjionale të barabarta me të gjitha ushtritë e rajonit. Ne jemi të përkushtuar që të zhvillohemi profesionalisht në mënyrë që gjithmonë të jemi të gatshëm t'u përgjigjemi nevojave të shtetit dhe qytetarëve të Kosovës, si dhe rajonit. Ne jemi të përkushtuar që të bëhemi vend kontribuues i sigurisë regjionale dhe globale". Komandanti i FSK-së për të gjitha të arriturat dhe zhvillimet profesionale të regrutëve të rinj të FSK-së, ka falënderuar dhe përgëzuar stafin e KDS-së, familjarët e ushtarëve të rinj, si dhe në veçanti partnerët ndërkombëtarë. Në emër të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes me një fjalë ka përshëndetur, komandanti i Qendrës Bazike majori Sami Hajrullahu. Në fund të ceremonisë rekrutët e rinj solemnisht dhanë betimin. Në ceremoninë e betimit të rekrutëve të rinj, morën pjesë: ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, atashetë ushtarakë, shefi i NLAT-it, gjeneral brigade Werner Haumann, drejtor i NAT-it, z. Domenic Braitwait, oficerë të lartë të FSK-së dhe të KFOR-it, si dhe familjarë të shumtë të rekrutëve. Në fund, instruktorëve iu dhanë mirënjohje për punën e tyre të suksesshme, ndërsa rekrutëve certifikatat për kryerjen me sukses të Kursit Bazik.











U certifikuan kadetët në kursin e karrierës për nënoficerë të FSK-së

Në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve në kursin e nënoficerëve të FSK-së.
Këtë kurs janë të obliguar ta kryejnë të gjithë nënoficerët e gradave tetar e kapter, dhe cilësohet si kurs i cili ofron mundësi karriere për nënoficerët, duke i pajisur me njohuri të reja dhe përvojë shtesë. Komandanti i KDS-së gjeneral brigade Enver Cikaqi, me këtë rast i përgëzoi të gjithë kadetët dhe instruktorët e tyre, për angazhimin, disiplinën dhe nivelin e arritjes profesionale që treguan gjatë kësaj periudhe shtatë javore. "Këtë gjeneratë të nënoficerëve, ne do ta kemi si model se si duhet të jetë një nënoficer në klasë të mësimit, por edhe në ushtrimet fushore dhe taktike në terren", tha gjeneral Cikaqi. Ai shtoi se, "nënoficeri si në çdo ushtri ashtu edhe tek ne është boshti kurrizor i ushtrisë dhe e ka vendin e duhur brenda çdo formacioni. Ne ofrojmë kurse trajnimesh të ndryshme për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, por kursi i nënoficerit është i rëndësisë së dyfishtë; në njërën anë përfiton njësia nga trajnimi i nënoficerit dhe në anën tjetër pjesëtari merr njohuri të reja për zhvillim të karrierës. Pas përfundimit të këtij kursi, secili prej jush do të jeni një udhëheqës i mirë dhe do të mbështesni fortë komandantët tuaj, andaj kërkoj nga ju që të tregoni vetë iniciativë dhe përkushtim, ashtu siç keni treguar për këto shtatë javë, këtu në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes"- përfundoi fjalën e tij, komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi. Kadetët gjatë këtij trajnimi u njoftuan me disa nga këto tema: Koncepti zhvillimor i nënoficerit, shkathtësitë e komunikimit, teknikat e ligjërimit, navigimi tokësor, manuali i taktikave, ndihma e parë, rregulloret rreshtore etj. Kursi i nënoficerit zhvillohet në mënyrë të kombinuar teori dhe praktikë. Si finalizim i kursit të nënoficerëve është mbajtur edhe një ushtrim fushor i nxjerr nga Manuali i taktikave dhe ndihma e parë dhe ka zgjatur tri ditë në terren, duke filluar me rregullimin e kampit dhe demonstrimin e aftësive fizike dhe profesionale.
Për kadetët të cilët treguan rezultate të larta dhe përkushtim në punë u ndanë mirënjohje nga Qendra për Zhvillim Profesional e



Udhëheqësve. Me mirënjohje për arritje akademike u nderua tetari Bujar Trena, për standard të lartë të udhëheqjes tetari Valon Geci, për disiplinë tetari Halim Vrella, për arritje të standardit në fitnes fizik tetari Valmir Murtezi, ndërsa çmimi i komandantit i takoi rreshterit Fadil Bungu. Certifikatat kadetëve ua dhanë komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe zëvendëskomandanti i Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve, major Skënder Haliti.

Rreshteri Fadil Bungu, ushtari më i mirë në kursin e karrierës të nënoficerëve



Në kursin e nënoficerëve të mbajtur nga data 02 mars 2015 deri më 17 prill 2015, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, u nda çmimi kryesor për arritje të jashtëzakonshme "Çmimi i komandantit", i cili takoi rreshterit Fadil Bungu. Fadil Bungu është pjesëtar i Kompanisë së Mirëmbajtjes në Batalionin e Logjistikës të Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO). Ai ka marrë pjesë në shumë trajnime si brenda dhe jashtë vendit, ku në të gjitha trajnimet, stërvitjet, kurset është dalluar për angazhimin, disiplinën dhe arritjen e rezultateve të mira. Në të gjitha këto trajnime, Bungu është dalluar me paraqitjen e shkëlqyeshme. Ai thotë se ka kryer trajnimin themelor në Vushtrri, trajnimin (10 mujor) në Gjermani, trajnimin për kërkimin, zbulimin dhe asgjësimin e mjeteve të improvizuara shpërthyese (si municione, granata të llojeve të ndryshme, bomba si dhe mjete jo ushtarake), EOD dhe IED. Njëri ndër trajnimet më të rëndësishme për Fadilin, padyshim që mbetet "Kursi i Avancuar për Lider" (KAL), pastaj trajnimi i mbajtur nga Njësia Trajnuese e Ushtrisë së Turqisë, që vepron në kuadër të KFOR, për oficerë dhe nënoficerë; trajnimi për grumbullimin, ruajtjen dhe asgjësimin e municioneve të armëve të lehta (vogla) të marruara nga duart e qytetarëve të Kosovës (këto municione të mbledhura nga Policia e Kosovës që të ketë sa me shumë siguri për qytetarët tanë, gjatë këtij trajnimi "kemi asgjësuar rreth 18, 000 fishekë të kalibrave të ndryshëm"); trajnimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), trajnimi me Policinë e Kosovës etj. Kurset dhe trajnimet e fundit janë më të freskëta për secilin kadetët, edhe për mua, Kursi Bazik i Nënoficerëve ka një peshë dhe vlerë të madhe; perspektivën e çdo pjesëtari të FSK-së. Gjatë këtij kursi kemi mësuar shumë tema të rëndësishme për ngritjen tonë profesionale, si: taktikat e lëvizjes, orientimi në natyrë, ushtrimi fushor, lidershipi, shkathtësitë e udhëheqjes, lufta urbane, etj, të cilat i kemi përmbyllur me ushtrimin fushor treditor, mbajtur natën dhe ditën. Ky çmim për mua ka domethënien e vet, sepse më bën të ndihem mirë dhe në anën tjetër më jep impulse për suksese të përgjithshme jo vetëm në aspektin individual por edhe atë kolektiv". Fadili krenohet me atë se në FSK të gjithë ata që e kryejnë kursin bazik e meritojnë ta marrin këtë çmim", shprehet në fund rreshter Bungu.

Trajnim i përbashkët i FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) u organizua ceremonia e certifikimit të 48 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët prej datës 15 deri më 17 prill 2015 kryen me sukses dy seminare; "Qendra Operative Luftarake" në të cilën morën pjesë 20 pjesëtarë dhe seminarin "Komanda dhe Kontrolli "të cilin e kryen 28 pjesëtarë nga njësi të ndryshme të FSK-së. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, falënderoi ekipin e instruktorëve të marinsave amerikanë për kryerjen me sukses të këtyre seminareve dhe Ambasadën Amerikane në Prishtinë. Gjeneral Rama vlerësoi lartë mbajtjen e seminareve që u realizuan gjatë këtyre ditëve të cilat ishin të rëndësishme për FSK-në, dhe kërkoi që këto njohuri të gjithë pjesëtarët t'i realizojnë me sukses tek pozicionet e tyre.
Ceremoninë e certifikimit e hapi togeri Cavanaugh i Marinsave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili u shpreh mjaft i kënaqur me realizimin e këtyre seminareve dhe njëherësh i falënderoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së për interesimin dhe angazhimin e treguar gjatë këtyre ditëve për të fituar njohuri dhe eksperienca të reja. Në fund, gjenerallejtënant Rrahman Rama i nderoi me mirënjohje instruktorët amerikanë të cilët kontribuuan në mbajtjen e këtyre trajnimeve.





Ministri dhe komandanti duke nderuar dëshmorët e Betejës së Koshares

Në përvjetorin e 16 të Betejës së Koshares, më 8 prill 2015, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me një delegacion të Ministrisë dhe të FSK-së, në nderim të dëshmorëve dhe të rënëve për Liri, bënë homazhe dhe vendosën lule në Varrezat e Dëshmorëve të Brigadës 138 "Agim Ramadani" në Koshare. Ministri dhe komandanti i FSK-së morën pjesë edhe në Manifestimin "Ditët e Shqipes" të mbajtur në patronazhin e kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa.

Intervistë me komandantin e KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi

FSK-ja në Konferencën Ndërkombëtare mbi Fuqinë e Hapësirës Ajrore në Turqi e barabartë me ushtritë pjesëmarrëse



"**Forca Jonë**": *Zoti gjeneral, çka mund të thoni për pjesëmarrjen tuaj në konferencën ndërkombëtar të mbajtur në Stamboll. ?*

Gjeneral Enver Cikaqi: Me ftesë të komandantit të Forcave Ajrore të Turqisë Gjeneral Akin OZTURK kam marrë pjesë duke përfaqësuar Forcën e Sigurisë së Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare mbi Fuqinë e Hapësirës Ajrore. Komandanti i FSK gjenerallejtënant Rrahman Rama më ka autorizuar të marrë pjesë në këtë konferencë të rëndësishme, jo vetëm për temat të cilat janë diskutuar por edhe rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë ngjarje të përmasave ndërkombëtare të FSK dhe të vendit tonë.

"**Forca Jonë**": *Çfarë do të thotë për Ju dhe për FSK-në pjesëmarrja në këtë konferencë?*

Gjeneral Enver Cikaqi: Konferenca organizohet çdo vit dhe kjo është hera e dytë që FSK merr pjesë, ndërsa organizimi është bërë me qëllim të diskutimit rreth fuqisë së hapësirës ajrore të shteteve pjesëmarrëse, mundësitë e participimit dhe nevojat e angazhimit. Sot Forcat ajrore në çdo ushtri kanë një rol të veçantë. Suksesi i të gjitha operacioneve luftarake të krizave ndërkombëtare nuk do të ishte pa pjesëmarrjen e Forcave ajrore, aleancave të fuqishme mes shteteve mike dhe teknologjisë së avancuar që sot kanë Forcat ajrore të ushtrive të vendeve të shumta. Fatmirësisht, shumica e vendeve që ishin prezent në konferencë ishin shtete që kanë njohur vendin tonë dhe që kanë ofruar ndihmë edhe për FSK-në, në forma të ndryshme. Në këtë drejtim, ftesa për pjesëmarrje në këtë konferencë ndërkombëtare do të thotë se Turqia por edhe shtetet anëtare të NATO-s, kanë një qëndrim pozitiv ndaj FSK-së. Forca e Sigurisë së Kosovës nëpërmes takimeve dhe konferencave të tilla me karakter ndërkombëtar ka ndërtuar partneritet me disa nga shtetet e NATO-s dhe shteteve tjera që nuk janë pjesë e Aleancës. Dhe falë kësaj sot kemi edhe një pjesë të oficerëve dhe nënoficerëve të cilët shkollohen dhe trajnohen nëpër kolegje dhe shkolla të këtyre shteteve, ndërsa njëra prej tyre është edhe Turqia, ku pjesëtarët tanë janë duke i vijuar shkollimet.

"**Forca Jonë**": *Cilat janë përvojat e pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare?*

Gjeneral Enver Cikaqi: Pjesëmarrja jonë në ICAP 15 në Stamboll ishte një mundësi e mirë për të marrë njohuri rreth komandim-kontrollit, zhvillimit të teknologjisë, ndërveprueshmërisë në mes të zhvillimit të hovshëm të teknologjisë dhe edukimit dhe stërvitjes së stafeve të Forcave Ajrore, rëndësisë së luftimit të përbashkët të rreziqeve aktuale ndërkombëtare etj. Në këtë konferencë ndërkombëtare kanë marrë pjesë nivele të larta të përfaqësimit të ushtrive të shumta të NATO-s dhe sigurisht që ka qenë një përvojë e mirë, nga e cila kemi mësuar si në aspektin e organizimit po ashtu edhe rëndësinë që ka kjo konferencë. Gjeneral me katër yje nga Ushtria amerikane Ushtria e Turqisë, gjeneralë nga Franca, Spanja, Norvegjia, Suedia, Pakistani, etj., kanë prezantuar përvojat e tyre dhe organizimin e sistemit të edukimit dhe stërvitjes së Forcave ajrore të ushtrive të tyre. Unë vlerësoj shumë organizimin e kësaj konference, jo vetëm me panelet e krijuara të ligjëruesve, temat të cilat janë ligjëruar por edhe protokollin e shkëlqyer të Forcave Ajrore Turke, që e ka bërë shumë të suksesshëm këtë ngjarje të rëndësishme.



"**Forca Jonë**": *Gjatë konferencës keni pasur edhe shumë takime me pjesëmarrës të konferencës dhe personalitete tjera ushtarake të Turqisë. A mund të na thoni diçka më shumë?*

Gjeneral Enver Cikaqi: Gjatë qëndrimit në Stamboll kemi pasur takime me gjeneral nga shtete si Turqia, SHBA, Spanja etj, me të cilët kemi biseduar për nevojat e bashkëpunimit dhe mundësinë e shkëmbimit të përvojave. Në çdo takim me këto delegacione, informuam miqtë tanë për të arriturat e FSK-së, nivelin profesional dhe nevojën e bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Po ashtu, përveç pjesëmarrjes në këtë konferencë ne kemi vizituar edhe hapësirat e Kolegjit të Luftës së Forcave Ajrore të Turqisë dhe kemi biseduar me Komandantin e këtij institucioni të rëndësishëm për format e bashkëpunimit edhe në të ardhmen mes FSK-së dhe ushtrisë turke. Në të gjitha takimet ishte një interesim i veçantë i tyre për t`u njohur me FSK-në dhe të arriturat, si dhe shprehnin edhe interesimin e tyre për të vizituar FSK-në dhe Republikën e Kosovës.

"**Forca Jonë**": *Zoti gjeneral ju keni takuar edhe shumë kadetët të FSK-së të cilët studiojnë në Turqi, si i shihni arritjet e tyre në aspektin profesional?*

Gjeneral Enver Cikaqi: Konferenca ndërkombëtare është mbajtur në ambiente të Kolegjit të Luftës në Stamboll, ku edhe dy oficerë tanë janë duke ndjekur shkollimin, si dhe një oficer tjetër tashmë ka përfunduar shkollimin dy vjeçar në Kolegjin e Luftës. Është kënaqësi kur dëgjoja për suksesin e oficerëve tanë, për përshtypjet e tyre për oficerët e FSK-së, që ishin jashtëzakonisht të mira. Ata vlerësoheshin se janë shumë aktiv, tregojnë përkushtim të lartë në edukim dhe stërvitje, për çka flasin edhe rezultatet e tyre. Por, ishte edhe një vlerësim i veçantë që iu bënin oficerët instruktorëve turq, por edhe stafi i Kolegjit, se të gjithë oficerët e FSK-së janë edhe të shoqërueshëm si me pjesëtarë të ushtrisë turke, ashtu edhe me pjesëtarë të ushtrive tjera në kolegjet dhe akademitë tona, që mua më bëri të ndjehem krenar. Në të njëjtën kohë pata rastin të takoj edhe disa oficerë dhe nënoficerë tjerë të cilët janë në Institutin e Gjuhëve të Huaja, ku pjesëtarët tanë janë duke mësuar gjuhën turke, për të ndjekur pastaj kurset profesionale në shkolla të ndryshme të Turqisë. Ndërsa gjatë takimit me pjesëtarët tanë e pamë se ishin të motivuar, tregonin se kanë marrë njohuri të mira gjatë shkollimeve dhe stërvitjeve, dhe se kjo periudhë ju ka shërbyer për të forcuar pozitën e tyre me njohuritë e marra. Gjithashtu kërkuam nga pjesëtarët tanë që të vazhdojnë ta përfaqësojnë FSK-në edhe në të ardhmen në mënyrë sa më dinjitoze, për arsye se ata janë edhe ambasadorët tanë në këto vende nga ku mund të përçojnë mesazh se si duket Forca e Sigurisë së Kosovës, çfarë organizimi ka dhe kështu mund të krijohet edhe një përshtypje për FSK-në, nga pjesëtarë të shumtë të ushtrive të NATO-s, të cilët kryejnë trajnimet bashkërisht.

Nga praktikat pozitive të FSK-së

Fuqizimi i rolit të gruas në institucionet e sigurisë



Major Remzie Zeqiraj, oficer për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 8 prill mori pjesë në konferencën "Fuqizimi i Rolit të Gruas në fushën e Sigurisë", me organizim të Asociacionit të Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës(KYATA), që u mbajt në lokalet e Fakultetit Filozofik të Prishtinës.

Në konferencë morën pjesë edhe nënkryetarja e Parlamentit të Kosovës, deputetja Aida Derguti, anëtarja e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, deputetja Ganimete Musliu, Dekani i Fakultetit Filozofik, prof. Bujar Dugolli, Kolonel Taibe Canolli nga Policia e Kosovës, Dajana Berisha nga Forumi për Iniciativë Qytetare, prof. Vjollca Krasniqi dhe Donika Emini nga Qendra Kombëtare për Studime të Sigurisë si dhe studentë dhe pjesëmarrës të tjerë. Major Remzie Zeqiraj, në emër të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, foli për pozitën dhe rolin e femrave në FSK si dhe kontributin që ato po japin çdo ditë në zhvillimin dhe profesionalizmin e këtij institucioni. Në vazhdim, major Zeqiraj foli edhe për pozitën e femrës ushtarake në FSK, duke shtuar se asaj i janë besuar detyra të rëndësishme komanduese si zëvendëskomandant, komandant kompanie, komandant togu, pastaj shef sektori etj. Majorja Remzie Zeqiraj tha se FSK-ja ka krijuar ambient pune të përshtatshëm për të dyja gjinitë dhe në vazhdimësi garanton zhvillim profesional dhe ngritje në karrierë për të gjitha ushtaraket dhe femrat civile që shërbejnë në Ministri dhe Forcë. Në punimet e konferencës ku u bisedua për fuqizimin e grave në fushën e sigurisë foli presidenti i KYATA-s, Besim Salihu, i cili tha se kjo konferencë është tema e parë po edhe aktiviteti i parë që KYATA ka organizuar me rastin e shënimit të Javës së NATO-s në Kosovë. Të gjithë pjesëmarrësit në referatet dhe diskutimet e tyre treguan se kjo temë nuk është më e re dhe e panjohur. Në diskutim u inkuadruan edhe shumë studentë të cilët kontribuuan me diskutimet e tyre.

Shkrimtari Riza Greiçevci ia dhuroi 200 libra FSK-së



Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, u organizua një ceremoni me rastin e pranimdorëzimit të një donacioni me libra nga shkrimtari, gazetari dhe publicisti i mirënjohur, z. Riza Greiçevci për Bibliotekën e FSK-së. Dhurimin e librave, e përshëndetën komandanti i Njësisë Ndërlidhëse për Reagim Ndaj Krizave (NJNRK) të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nënkoloneli Milaim Musliu dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i Ministrisë së FSK-së, z. Hajrush Kurtaj. Zoti Kurtaj tha se kjo ndihmë është e një rëndësie të veçantë për ne, sepse librat janë dhuratë e çmuar nga shkrimtari i dalluar në shumë fusha krijuese, z. Riza Greiçevci. Ndërsa, z. Greiçevci tepër i emocionuar tha :"Është nder për mua, dhe e ndiej vetën të privilegjuar që pata mundësi ta ndihmojë Bibliotekën e FSK-së. Të gjitha këto libra janë krijime personale nga fusha të ndryshme letrare, ku pjesëtarët e FSK-së, kadetët, ushtarët dhe edhe ata që janë studentët do të kenë mundësi të pajisen me dije. Biblioteka është simbol i punës dhe së ardhmes së ndritur të këtij populli. Besoj se kjo nuk do të jetë ndihma e parë dhe as e fundit e imja, tha në fund, z. Greiçevci. Riza Greicevci deri më tani ka shkruar dhe botuar mbi 75 vepra me tema të ndryshme, si romane, poezi, drama, ese, publicistikë etj.

Biblioteka e Forcës së Sigurisë së Kosovës është themeluar më 12 prill të vitit 2011, dhe ka një numër të konsiderueshëm të librave (9000) nga të gjitha fushat, si ajo ushtarake dhe fusha e letërsisë. Deri më tani, me libra dhe literaturë të ndryshme Bibliotekën e FSK-së e kanë ndihmuar shumë institucione dhe individë, si Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, KFOR-i amerikan, veprimtarë dhe shkrimtarë të Kosovës, të cilët kanë dhuruar literaturë të shumëllojshme si nga letërsia, arti, historia, fizika, filozofia, literaturë të fushës ushtarake dhe zhanreve të ndryshme si dhe Kolegji Mbretëror i Danimarkës i cili i ka dhuruar Bibliotekës së FSK-së mbi 1000 libra.

Pjesëtarët e FSK-së përfunduan trajnimin për operacione civilo-ushtarake

Departamenti i BCU në bashkëpunim me Zyrën për Mbështetje Civilo-Ushtarake pranë Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, nga data14-17 prill 2015, në ambientet e kazermës "Adem Jashari" organizuan trajnimin për operacione civilo-ushtarake në të cilin morën pjesë 27 pjesëtarë nga të gjitha njësitet e FSK-së. Qëllimi i mbajtjes së këtij trajnimi ishte që pjesëtarët e FSK-së, të përvetësojnë konceptin bazik lidhur me funksionimin e BCU-së, gjatë operacioneve për mbështetje humanitare në raste të krizave si brenda dhe jashtë vendit. Trajnimi është realizuar nga instruktorët amerikan, zotërinjtë Jeffrey Carroll dhe Kristofor Jacobson, ku janë trajtuar këto tema: Operacionet e kërkim-shpëtimit, ndërmjetësimi, vetëdijesimi kulturor dhe etnik dhe komunikimi me liderët kyç etj. Në fjalën e tij, atasheu ushtarak i SHBA-ve, koloneli Chad Butts tha se Zyra për Bashkëpunim ka qenë dhe do të jetë në përkrahje të trajnimeve për pjesëtarët e FSK-së. Me këtë rast, Ai përshëndeti instruktorët dhe pjesëtarët e FSK-së të cilët kryen me sukses këtë trajnim katër ditor. Koloneli Butts shtoi se është me shumë rëndësi të dimë se si t'i dalim në ndihmë popullatës në rast nevoje. Trajnimet e tilla janë shumë më rëndësi, sepse mundësojnë t'iu qasemi problemeve si profesionist të vërtetë. Ndërsa, drejtori i Departamentit të BCU-së, z. Hajrush Kurtaj, fillimisht falënderoj Zyrën për 'Mbështetje Civilo-Ushtarake dhe ligjëruesit Jeffrey Carroll dhe Kristofor Jacobson, si dhe të gjithë ata që kontribuon në realizimin e këtij trajnimi të suksesshëm. Ai shtoi se ky trajnim është i mirëseardhur dhe korrespondon me objektivat e ministrit, komandantit dhe të gjithë stafit udhëheqës të FSK-së, për përgatitjen e kuadrove me njohuri të avancuara në fusha të ndryshme. Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak është njëri ndër elementet më të rëndësishme të zhvillimit të FSK-së. Ky bashkëpunim pranohet dhe avancohet gjithnjë e më shumë jo vetëm nga FSK-ja, por edhe nga partnerët tanë të jetës civile. Ne jemi të bindur se ky trajnim do t'na shërbejë shumë në kryerjen e detyrave profesionale në të ardhmen si në Kosovë ashtu edhe në misione humanitare dhe të mbështetjes jashtë vendit. Drejtori i BCU-së, z. Kurtaj, në emër të komandantit të FSK-së, gjeneralleitënant Rrahman Rama, u dha mirënjohje për instruktorët amerikanë, Jeffrey Carroll dhe Kristofor Jacobson.



Gjatë ceremonisë ishin të pranishëm Hajrush Kurtaj drejtor i Departamentit të BCU-së, atasheu ushtarak i SHBA-ve, koloneli Chad Butts, z. Jason Stumph- udhëheqës i ekipit Civilo-Ushtarak në Ambasadën Amerikane, majori Adam Giroux- Zyra për Bashkëpunim, majori Tom Melton- Zyra e Atasheut Ushtarak Amerikan si dhe zyrtarë dhe oficerë të lartë të Ministrisë dhe të FSK-së.

Intervistë me dy pjesëtare të FSK-së, nga radhët e komunitetit serb

Tetar Cvetanoviq: FSK-ja është institucioni që promovon siguri në Kosovë

"**Forca *Jonë*":** *Kur jeni inkuadruar në FSK dhe cila është pozita juaj?*
Tetar Olivera Cvetanovi: Jam pjesëtare e FSK-së që nga 21 janari i vitit 2009. Jam e sistemuar në skuadrën e Mjekësisë në Batalionin e Parë të Reagimit të Shpejtë, si teknike, këtu në Gjilan.

"**Forca Jonë":** *Cili është bashkëpunimi juaj me pjesëtarët tjerë të FSK-së?*
Tetar Olivera Cvetanoviq: Batalioni i Parë numëron 359 pjesëtarë. Në mesin e tyre ka pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme. Unë si teknike mjekësore, në kuadër të punës që bëj, kam kontakte pothuajse me të gjithë pjesëtarë e batalionit. Dua të ju them së bashkëpunimi me ta është i shkëlqyeshëm dhe shpresoj të jetë kështu edhe në të ardhmen.



"**Forca Jonë":** *Si e shihni veten në të ardhmen si pjesëtare të FSK-së?*
Tetar Olivera Cvetanoviq: FSK-në e shoh si institucionin më të besueshëm në Kosovë, kështu mendoj së do jetë edhe në të ardhmen, një institucion që promovon siguri. Unë në të kaluarën kamë qenë edhe pjesë e TMK-së, dhe me një numër të kolegëve



jemi duke punuar bashkë tash e sa vite, andaj nuk shoh as në të ardhmen ndonjë arsye që të mos punojmë së bashku edhe si kolegë të njëjtit institucion.

"**Forca Jonë":** *Cila është porosia juaj për pjesëtarët e komunitetit tuaj dhe për gjithë të rinjtë?*
Tetar Olivera Cvetanoviq: Porosia ime për të gjithë qytetarët e Kosovës jo vetëm të komunitetit serb, është: "Bëhuni pjesë e FSK-së sepse do të ndiheni krenar".
Ushtar Jovana Jovanoviq: Jam pjesëtare e FSK-së që nga gushti i vitit 2013. Jam e sistemuar në Togun e Tretë të Kompanisë 1C, Batalioni i 1-rë i Reagimit të Shpejtë. Me kolegët e Kompanisë 1C, por edhe me të gjithë pjesëtarët e batalionit kam një bashkëpunim të shkëlqyeshëm, ku dhe gjitha detyrat në kuadër të punës i realizojmë duke respektuar pozitat dhe marrëdhëniet kolegjiale. Mendoj se ky bashkëpunim i shkëlqyer do jetë një vlerë për FSK-në tani dhe në të ardhmen. Deri me tani nuk kam pasur asnjë problem me kolegët, përkundrazi kam gjetur përkrahjen e tyre sa herë që kam pasur nevojë, e çmoj lartë bashkëpunimin nder kolegjial. Të qenit pjesë e FSK-së, për mua d. m. th. shumë. Së pari të ofron një punë me një pagë të arsyeshme dhe të sigurt, pastaj të bën të ndihesh mirë me respektin që të bëjnë kolegët. Mesazhi im për bashkëqytetarët është: "Bëhuni pjesë e FSK-së, sepse është institucion i mundësive të mëdha për të gjithë qytetaret pa asnjë dallim".

Studiuesi Zenun Rexhepi ia dhuroi FSK-së 8 tituj librash

Publicisti dhe shkrimtari i dalluar prof. Zenun Rexhepi i dhuroi Bibliotekës së Forcës së Sigurisë të Kosovës tetë (8) tituj librash me gjithsej 26 ekzemplarë, krijime personale, me dëshirën se ato do të jenë literaturë e dobishme për pjesëtarët e FSK-së dhe adhuruesit e librit.
Profesor Zenun Rexhepi fillimisht u prit nga komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe më pas edhe nga shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel Naim Haziri së bashku me stafin udhëheqës të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim



Ndaj Krizave (NJNRK) të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Dorëzimpranimi i librave u bë në ambientet e Bibliotekës të NJNRK-së, në një atmosferë bashkëpunimi dhe mirënjohje.
Me këtë rast, publicisti dhe shkrimtari Rexhepi u shpreh: "Shfaq kënaqësinë e veçantë që m'u dha rasti t'i vizitoj dy institucionet tuaja të rëndësishme me rastin e dhurimit të disa prej titujve që i kisha në dispozicion. Më gëzon fakti se i pashë me sytë e mi të arriturat prej vitit 1999 e tutje, që janë vazhdimësi e luftës për çlirimin demokratik të Kosovës. Ju uroj edhe shumë suksese të reja për të mirën e shtetit të Kosovës dhe të popullit shqiptar në përgjithësi "-tha në fund të fjalës së tij publicisti Rexhepi. Ky aktivitet u koordinua nga drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i Ministrisë së FSK-së, z. Hajrush Kurtaj.

Nxënës dhe arsimtarë nga Suedia vizituan Kazermën e FSK-së në Gjilan



Në grup prej 43 nxënësish, së bashku me arsimtarët e tyre suedezë dhe shqiptarë, të cilët jetojnë dhe studiojnë në Suedi, vizituan Kazermën e Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së në Gjilan. Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit të FSK-së me Ministrinë e Diasporës së Kosovës. Nxënësit dhe arsimtarët e tyre nga Suedia u priten nga kapiteni Blerim Sahiti dhe oficerë tjerë të FSK-së, të cilët i njoftuan me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, përkatësisht të Batalionit të Parë të BRSH-së. Pas prezantimit të të arriturave të FSK-së, ata u interesuan që të informohen për të arriturat e përgjithshme të FSK-së si dhe të mësojnë për kriteret e pranimit të të rinjve në FSK. Më pas grupi nga Suedia vizitoi edhe ambientet e Batalionit të Parë si dhe përcolli nga afër një demonstrim të pjesëtarëve të këtij batalioni.
Për nder të nxënësve dhe arsimtarëve nga Suedia, në ambientet e restorantit të FSK-së u shtrua një drekë e përbashkët ku drekuan së bashku nxënësit dhe ushtarët e FSK-së.
Nxënësit dhe arsimtarët nga Suedia u ndanë të kënaqur me pritjen dhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së.

Certifikohen pjesëmarrësit e trajnimit "Personi i Parë në Vendngjarje"

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" është mbajtur ceremonia e certifikimit të trajnimit "Personi i Parë në Vendngjarje". Ky trajnim u organizua nga Zyra e Atasheut Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar dhe u realizua nga pjesëtarët e Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog.

Në ceremoninë e certifikimit prezantuan: Gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione, kolonel Xhevahir Geci ushtrues i detyrës së komandantit të BRSH-së, kolonel David Jones këshilltar ushtarak i komandantit të FSK-së, kolonel Xhevdet Tahiraj, drejtor i Departamentit të Mjekësisë në MFSK-së, major Ejup Maqedonci, ushtrues i detyrës së shefit të Shtabit të BRSH-së, si dhe oficerë dhe ushtarë të FSK-së. Gjeneral brigade Zymer Halimi, me këtë rast, theksoi





rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm që ka FSK-ja me Mbretërinë e Bashkuar dhe kontributin që këta të fundit kanë dhënë dhe po japin në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, përmes trajnimeve të tilla dhe të llojeve tjera. Gjeneral Halimi falënderoi këshilltarin e KOMFSK kolonelin David Jones, për punën dhe për përpjekjet e tij të vazhdueshme në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së. Ekipi i instruktorëve të Mbretërisë së Bashkuara e ka vlerësuar shumë lart motivimin, angazhimin dhe pjesëmarrjen e pjesëtarëve të FSK-së në këtë kurs. Të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit kanë përfunduar me sukses testimin. Prej dy grupeve janë përzgjedhur 6 pjesëtarët më të mirë për të vazhduar me avancimin profesional të tyre për paramedikë dhe trajnues në të ardhmen.

Trajnimi është zhvilluar në dy grupe, nga data 30 mars deri më 10 prill 2015. Trajnimin "Personi i Parë në Vendngjarje" e kanë kryer 27 pjesëtarë të BRSH-së, përfaqësuar nga të tri batalionet e BRSH-së.

Në kursin Procedurat Shtabore Komanduese u certifikuan 15 pjesëtarë të FSK-së

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, përfundoi kursi "Procedurat Shtabore Komanduese" të cilin e realizuan instruktorët e Qendrës Kolektive të Stërvitjes të KDS-së. Kursi ka zgjatur katër javë dhe kanë marrë pjesë 15 pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së. Për rolin, rëndësinë, nivelin e përgatitjes dhe angazhimet gjatë këtij kursit, foli shefi i Shtabit të KDS-së kolonel Fadil Hadërgjonaj i cili ndër të tjera tha: " Ky kurs të cilin e



kanë ndjekur oficerë dhe nënoficerë të njësive të FSK-së, përgatitë pjesëtarët tanë për udhëheqje dhe komandim të trupave, vlerësim të ushtrimeve, por edhe zhvillon udhëheqësin në karrierën profesionale. Atë që ju keni treguar në këtë periudhë relativisht të shkurtër është shumë më rëndësi të theksohet se vetëm me një përkushtim të lartë arrihen këto rezultate. Është një e mirë që trajnimet në KDS janë duke u zhvilluar me metoda të kombinuar, teori dhe praktikë, ku pjesa kryesore ka qenë pjesë praktike, ndërsa testi final na ka dhënë të kuptojmë se pjesëtarët kanë treguar përkushtim gjatë këtij kursi"- përfundoi fjalën e tij, nënkolonel Hadërgjonaj.

Disa nga temat e kryesore të kursit kanë qenë: Alarmi, udhëheqja dhe komandimi, kontrolli, planifikimi, organizimi, vlerësimi i trajnimeve dhe ushtrimeve, procesi i planifikimit operacional, planet dhe urdhrat, dizajnimi dhe funksionimi i shtabeve, sistemi i informative gjeografike (GIS) etj. Në fund, shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Fadil Hadërgjonaj dhe zëvendëskomandanti i Qendrës Kolektive të Stërvitjes, kapiten Avni Bunjaku, për pjesëmarrësit e kursit ndanë certifikata.

Kompania e Batalionit të Parë të BRSH-së përmbylli me sukses ushtrimin fushor "Ujku 1C Godet"

Kompania 1C e Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë e FSK-së, që nga data 31. 03. 2015 deri më 03. 04. 2015, ka realizuar ushtrimin fushor të koduar me emrin "Ujku 1C Godet". Ky aktivitet është realizuar në bazë të ciklit tremujor të trajnimeve dhe listës së detyrave esenciale për zbatimin e misionit dhe planit vjetor të aktiviteteve të Brigadës për Reagim të Shpejtë. Qëllimi kryesor i këtij ushtrimi ishte testimi i gatishmërisë operacionale, funksionimi i nënoficerëve liderë në nivel kompanie, togu, skuadre dhe ekipi.

Kompania 1C me të pranuar mesazhin e alarmimit, duke respektuar të gjitha afatet kohore ka ngritur gatishmërinë në nivelin e III-të, ku kërkohej që të jetë e gatshme që sipas urdhrit të operoi në zonën e operacionit, për të kryer operacionet e sigurisë. Në ushtrimin fushor të Kompanisë 1C, ishin të angazhuar 232 pjesëtarë, duke përfshirë këtu edhe personelin nga Komanda e Batalionit, Kompania Mbështetëse dhe Simulantët.

Ushtrimi fushor ishte tejet sfidues, ku personeli u ballafaqua me kushte të vështira atmosferike dhe skenarë të ndryshëm, të cilët i mundësonin Kompanisë 1C zhvillimin e operacioneve të sig-



urisë dhe forcimin e trajnimeve paraprake. Aktivitetet/operacionet u zhvilluan kryesisht në malet e Jezercit në regjionin e Ferizajt, ku u testua edhe komunikimi me Radio Harris dhe Motorolla. Ky aktivitet zgjati tri ditë, duke i mundësuar personelit të K1C të realizojë një mori aktivitetesh të cilat janë mësuar gjatë fazës së trajnimit. Aktivitetet e realizuara gjatë ushtrimit fushor ishin: alarmimi, marshimi, ngritja e kampit fushor, ngritja e komandave taktike, navigimi natën, operacione urbane, operacione malore, pikë vëzhgimi, pikë kontrolli, kontrolli i zonës, koordinimi me autoritetet lokale dhe testimi i qëndrueshmërisë fizike.

Ushtrimin fushor e përcollën nga afër dhe përfaqësuesit e NLAT-it, ekipit këshillues të NATO-s për FSK-në. Ushtrimi fushor "Ujku 1C Godet" ka përfunduar me sukses, duke arritur kështu edhe qëllimin e mbajtjes së tij.

Kontingjenti i KFOR-it Turk trajnoi pjesëtarë të Batalionit të Parë të BSH-së në Gjilan

Në Gjilan u mbajt ceremonia e certifikimit të 28 të pjesëtarëve të Kompanisë 1A, të Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, të cilët përfunduan me sukses trajnimin tre mujorë (12 janar 2015 deri më 02 prill 2015), me ekipet e KFOR-it turk. Në ceremoninë e certifikimit, ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, kolonel Xhevahir Gaci falënderoi ekipet turke që tash e sa vite janë duke i trajnuar njësitë e Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe kërkoi nga pjesëtarët të cilët sapo kanë përfunduar këtë trajnim që njohuritë e tyre t'i përcjellin në njësitet ku shërbejnë. Ndërsa, koloneli Demirgjogllu përgëzoi pjesëtarët e Kompanisë 1A dhe premtoi se do vazhdojnë me trajnime të tilla edhe në të ardhmen. "Përkushtimi dhe entuziazmi i instruktorëve dhe pjesëtarëve në ketë trajnim ka qenë në nivelin më të lartë, gjë që ka bërë që trajnimi të jetë më atraktiv dhe shumë frytdhënës"- tha ushtruesi i detyrës së komandantit të Batalionit të Parë, major Ibrahim Revuqi.

Pjesëtarët të cilët kanë ndjekur këtë trajnim kanë marrë njohuri të reja në ngritjen e shkathtësive individuale dhe kolektive, njohuri këto që do tu shërbejnë për zhvillimin e forcës, u tha gjatë ceremonisë.

FORCA JONË

* * * Viti IV • Nr. 35 • Qershor 2015 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri Haki Demolli dhe gjeneral Rrahman Rama takuan gjeneralin nga Turqia Erdal Ozturk

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën në takim të përbashkët një delegacion të lartë ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë në krye me gjenerallejtënant Erdal Ozturk. Ministri Haki Demolli, fillimisht, falënderoi gjeneralin Ozturk dhe nëpërmjet tij Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet dy forcave, dy ministrive dhe të dy vendeve tona. Gjithashtu, ministri Demolli tha se bashkëpunimi ynë në kuadër të marrëveshjes dypalëshe është duke u realizuar në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Ministria e FSK-së dhe Forca e Sigurisë së Kosovës janë të përkushtuara që ky bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke shprehur njëherësh mirënjohje për kontributin e gjithanshëm që Forcat e Armatosura të Turqisë po japin për shkollimin dhe trajnimin e pjesëtarëve, e gjithashtu edhe për mbështetjen me pajisje të nevojshme. Ministri Demolli po ashtu shprehu konsideratën e tij të lartë për kontributin e palodhshëm të Kontingjentit turk, i cili shërben në kuadër të KFOR-it, për sigurinë dhe paqen në vendin tonë. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama pasi që falënderoi gjeneralin Ozturk për vizitën, tha se Forcat e Armatosura të Turqisë në vazhdimësi kanë treguar që janë partner i rëndësishëm për FSK-në, dhe se kontributi i Ushtrisë së Turqisë në shumë fusha ka qenë jashtëzakonisht i dobishëm për zhvillim e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në veçanti gjeneral Rama shprehu konsideratë për përmbushjen e planeve të shkollimit, trajnimit dhe mbështetjes, të cilat kanë dalë dhe do të dalin edhe në të ardhmen, bazuar në marrëveshjen dypalëshe që kemi aktualisht. Ndërsa gjenerallejtënant Erdal Ozturk, shef i Operacioneve në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë, ndër të tjera, gjatë fjalës së tij, tha se Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes me gatishmërinë më të madhe ka ofruar kapacitetet e saj në të mirë të zhvillimit profesional e operacional të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ne, shtoi gjenerali Ozturk, në bazë të planit dhe marrëveshjes qe kemi bashkë, do t'i shtojmë angazhimet tona që në të ardhmen të rrisim numrin e trajnimeve duke identifikuar edhe fusha të tjera të nevojshme për mbështetjen tuaj në këtë fazë, si



dhe në të ardhmen për ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura.

Pjesë e delegacionit të gjenerallejtënant Erdal Ozturk ishin edhe gjenerallejtënant Omer Pac, shef i Shëndetësisë në Forcat e Armatosura të Turqisë dhe komandanti i GATA-s(Spital ushtarak), pastaj, kolonel Hasan Aydoglu atashe ushtarak i Republikës së Turqisë në Kosovë, kolonel Omer Demircioglu dhe kolonel Gyltekin Yarali.

Ministri Haki Demolli dhe gjeneral Rrahman Rama e pritën në takim gjeneralin gjerman Hans Werner Fritz





Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën në takim të përbashkët komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara për Operacione të Forcave të Armatosura të Republikës Federale Gjermane, gjenerallejtënant Hans Werner Fritz dhe delegacionin e tij.

Në takim, ministri Demolli falënderoi gjeneralin gjerman Fritz për bashkëpunimin e frytshëm dhe të vazhdueshëm në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë si dhe të dy Forcave. Ministri Demolli po ashtu u shpreh mirënjohës për mbështetjen dhe kontributin që ka dhënë Gjermania, përkatësisht Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të FSK-së. Më tutje, ministri i FSK-së, Haki Demolli e njoftoi gjeneralin Hans-Werner Fritz lidhur me zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për procesin nëpër të cilin po kalon kjo Forcë si dhe gjendjen e tanishme politike rreth transformimit të FSK në Forca të Armatosura. Zotëri Demolli tha se i gjithë ky proces është shumë transparent dhe se jemi shumë të gatshëm që kjo të bëhet në koordinim të përhershëm me vendet mike dhe partnere në proces.

Ndërsa, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama në takim foli rreth planeve për transformimin dhe zhvillimin e Forcës në të ardhëm, duke potencuar faktin se janë në proces përgatitjet si për strukturë ashtu edhe për doktrinat, dhe se ky planifikim vazhdimisht është bërë dhe po bëhet në koordinim me Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në(NLAT) dhe me Ekipin Këshillues të NATO-s për MFSK-në (NAT). Gjeneral Rama në fund tha se FSK-ja si institucion shumetnik është e hapur dhe ne jemi duke ndërtuar një forcë për të gjithë qytetarët pa dallim. Edhe gjatë procesit të transformimit do të jemi transparent me të gjithë qytetarët e vendit, shtetet fqinje dhe me partnerët tanë. Komandanti i FSK-së, në përmbyllje të fjalës së tij theksoi se jemi të interesuar të ndërtojmë një Forcë fleksibile me standarde të NATO-s, dhe se synimi ynë është që të jemi vend anëtar me të drejta të plota në NATO. Nga ana e tij, gjenerallejtënant Hans-Werner Fritz tha se Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes së Gjermanisë ka përcjellë nga afër zhvillimet në FSK dhe se do ta ndjek me vëmendje të veçantë edhe fazën e procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura. Gjenerali Fritz më tutje shtoi se ndjehet i lumtur që krerët e FSK-së kanë filluar një proces në mënyrë transparente dhe ai garantoi mbështetje të vazhdueshme për FSK-në si në pajisje ashtu edhe në trajnime dhe fusha tjera me interes reciprok.

Në takim ishin të pranishëm edhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjeneral brigade Werner Haumann, drejtor i NLAT-it, nënkolonel Rupert J.J Steeger, atashue ushtarak i Republikës së Gjermanisë në Kosovë, nënkolonel Michael Gierse, këshilltar gjerman në MFSK dhe nënkolonel Fadil Hoxha, asistent ushtarak i KOMFSK-së.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë janë duke i thelluar raportet e bashkëpunimit sipas marrëveshjes dypalëshe.



FSK-ja dhe Ushtria amerikane zhvilluan stërvitje të përbashkët

FAQE 4-5

Zëvendësministri i MFSK-së Fadil Gashi mori pjesë në Panairin e 12-të Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes në Turqi



Me ftesë zyrtare të Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Turqisë, z. Ismet Jëlmaz nga data 04-09 maj 2015 , delegacioni i MFSK-së i udhëhequr nga zëvendësministri i FSK-së Fadil Gashi, i shoqëruar nga atasheut ushtarak i Kosovës në Turqi, nënkolonel Bekim Osmani, shefi i Sektorit të Planeve, Programeve dhe Analizave në MFSK-së, nënkolonel Sefer Isufi mori pjesë në Panairin e 12 Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes në Stamboll.

Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm edhe Presidenti i Republikës së Turqisë, ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë dhe delegacione të larta ministrore dhe ushtarake të rreth 80 shteteve. Gjatë këtij qëndrimi zëvendësministri Fadil Gashi realizoi një varg takimesh me personalitete politike dhe ushtarake të vendeve të ndryshme. Takimi më i rëndësishëm ishte ai me homologun dhe nikoqirin e tij, zëvendësministrin e Mbrojtjes së Turqisë zotin Hasan Kemal Jardëmxhë.

Në këtë takim zëvendësministri Gashi vlerësoi lart mbështetjen e dhënë në të gjitha fushat nga ana e Qeverisë së Republikës së Turqisë, përkatësisht Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Turqisë, në ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së.

Zëvendësministri Jardëmxhë vlerësoi lart të arriturat e MFSK-së dhe FSK-së, duke shprehur fuqishëm gatishmërinë për mbështetje të vazhdueshme dhe ngritjen e bashkëpunimit në mes dy vendeve mike, në mes të dy ministrive përkatëse si dhe Forcave të Armatosura të Turqisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë kësaj vizite zëvendësministri i FSK-së Fadil Gashi vizitoi edhe stafin e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stamboll, ai njëherësh takoi edhe shumë oficerë të FSK-së që gjenden për shkollim dhe trajnim në qendrat ushtarake në Stamboll.



Gjenerali Rrahman Rama priti ambasadorin e Shqipërisë Qemal Minxhozin

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim zyrtar ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi, i cili në emër të shtetit shqiptar, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë e uroi komandantin Rama për detyrën e re. Gjeneral Rama duke falënderuar ambasadorin Minxhozi, vlerësoi lartë shkallën e bashkëpunimit në mes të dy shteteve, ministrive përkatëse si dhe FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ai theksoi se ky bashkëpunim ka qenë shumë i frytshëm sidomos në fushat e shkollimit, trajnimit dhe ushtrimeve të përbashkëta. Nga ana e tij ambasadori Minxhozi vuri në dukje nivelin e mirë të bashkëpunimit në mes të dy shteteve, duke pohuar se, thellimi i këtij bashkëpunimi nuk është vetëm në të mirë të dy shteteve tona, por edhe në të mirë të sigurisë së rajonit dhe më gjerë. Me këtë rast ambasadori Minxhozi nënvizoi se përvojat e Shqipërisë si një vend anëtar i NATO-s do të jenë të dobishme edhe për Kosovën drejtë objektivit të saj për të qenë anëtare e NATO-s.

Inspektori Gjeneral i MFSK-së, gjeneral brigade Bashkim Jashari vizitoi Kroacinë dhe Sllovenинë



Inspektori Gjeneral i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, gjeneral brigade Bashkim Jashari, që nga data 13deri më 15 majë 2015, qëndroi për një vizitë pune në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë.

Gjeneral brigade Bashkim Jashari së bashku me bashkëpunëtorët e tij u prit në Inspektoratin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë nga Inspektori Gjeneral i MMRK-së, gjenerallejtënant Mirko Sundov dhe zëvendës Inspektori Gjeneral, gjeneral brigade Slaven Zvilkov dhe stafi i gjerë i Inspektoratit. Gjatë takimit u shkëmbyen përvojat dhe njohuritë e të dy organizmave përkatës, si dhe u theksua nevoja e bartjes se përvojave dhe njohurive në kuadër të përmbushjes së standardeve monitoruese të nevojshme për integrim në NATO. Të dy Kryeinspektorët u pajtuan se bashkëpunimi dypalësh në këtë fushë është shumë i mirëpritur, duke pasur parasysh potencialin e përbashkët për bashkëpunim.

Gjatë qëndrimit në Kroaci, gjeneral Jashari i shoqëruar nga gjenerali Zdilar vizitoi Akademinë e Mbrojtjes së Kroacisë, ku u prit nga komandanti i saj, gjenerallejtënant Slavko Baric dhe stafi i lartë i Akademisë së Mbrojtjes. Gjatë kësaj vizite u prezantuan kapacitet edukative, stërvitore dhe trajnuese. Të dy gjeneralët biseduan për mundësinë e bashkëpunimit në këtë fushë, në mes të dy institucioneve. Ndërsa, në ditën e tretë të vizitës, gjeneral Jashari i shoqëruar nga gjenerallejtënant Sundov vizitoi industrinë ushtarake të Kroacisë, ku u njoftua mbi kapacitet dhe mundësitë e bashkëpunimit në këtë fushë.

Inspektori Gjeneral i MFSK-së, gjeneral brigade Bashkim Jashari nga data 20 deri më 22 maj 2015, qëndroi për vizitë zyrtare edhe në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë, përkatësisht në Inspektoratin e kësaj Ministrie. Gjeneral Jashari u prit nga Kryeinspektori M. SC. Roman Zupanec, shefi i Divizionit Civil të Mbrojtjes së Sllovenisë M. Sc. Bojan Benedik si edhe inspektori i lartë kolonel Tomaz Okraslar. Gjatë takimit dypalësh ata diskutuan për çështje që i preokupojnë të dy inspektoratet përkatëse. Gjatë takimeve në Inspektoratin e Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë u diskutua lidhur me funksionimin e përgjithshëm të inspektorateve , programet trajnuese të Inspektoratit të Sllovenisë, aktivitetet praktike të inspektimit dhe bashkëpunimi me organizmat tjera të mbikëqyrjes.

Në kuadër të kësaj vizite, gjeneral Jashari u pritë edhe nga Sekretari Shtetëror i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë, Msc. M. Bizjak. Gjatë këtij takimi u bisedua për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, duke e cilësuar si mjaft të suksesshëm bashkëpunimin e deritashëm. Gjenerali Jashari këto vizita i cilësoi të dobishme, edhe për shkak të fazës në të cilën gjendet FSK-ja, ngase siç thotë Ai, "ne i kemi konfirmuar kapacitetet e nevojshme si Forcë të tanishme, dhe synimi ynë është bërja e mekanizmave efektivë të mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm edhe për fazat e ardhshme, në të cilat ne si forcë mund të avancojmë.



Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s në Romë

Drejtori i Drejtorisë për Politikë dhe Plane nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Faruk Geci mori pjesë në seminarin e nivelit më të lart strategjik, atë të gjeneralëve dhe ambasadorëve që u zhvillua në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-së në Romë të Italisë. Tematikë e këtij seminari ishin çështjet strategjike të zhvillimeve globale në fushën gjeopolitike, ekonomike dhe ushtarake në Evropë dhe SHBA. Gjatë një jave sa edhe ka zgjatur ky seminar është biseduar edhe për ndërlidhjen me krizën në Ukrainë dhe Rusi, Lindje të Mesme dhe Afrikë Veriore si dhe çështjet e ngritjes ekonomike dhe ushtarake të Kinës.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjeneral brigade Enver Cikaqi mbajti ligjëratë për ushtarakët amerikanë në "Bondsteel"



Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi me ftesë të Komandantit të Grupit Luftarak Shumëkombësh Lindje ,,Bondsteel", kolonelit Clinton Baker mbajti një ligjëratë për ushtarakët amerikanë në kampin ,,Bondsteel" në Sojevë me temën"Përvoja dhe perspektiva personale si pjesëmarrës i UÇK-së, Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK) dhe FSK-së". Komandanti i KDS, gjeneral Cikaqi iu drejtua një audience të gjerë të oficerëve dhe nënoficerëve të lartë të Grupit Luftarak Shumëkombësh Lindje, në kudër të KFOR-it, të cilët treguan interesim të lartë për të dëgjuar ligjëratën dhe tematikën e shtjelluar.

Ligjërata ishte fokusuar kryesisht në një historik të shkurtër të Kosovës para fillimit të luftës së UÇK-së, fillet e organizimit të luftës, pastaj transformimi i UÇK-së në TMK, shuarjen e TMK-së dhe ngritjen e FSK-së dhe vazhdimi i rrugës drejt përmbushjes së ëndrrës shekullore për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Fokusi i ligjëratës së gjeneralit Enver Cikaqi ishte tek bashkëpunimi me miqtë ndërkombëtarë gjatë këtyre periudhave të vështira nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe institucionet e saj, e në këtë kuadër edhe sfidat me të cilat është ballafaquar UÇK-TMK-FSK gjatë transformimit e deri në ditët e sotme në pritje të misionit të ri.

Komandanti i KDS-së, gjeneral Enver Cikaqi, me këtë rast tha :" Do ta veçoja kontributin e Ushtrisë amerikane e cila vazhdimisht ka shprehur gatishmërinë që të ofrojë mbështetje për FSK-në, në ndërtimin dhe konsolidimin e strukturës, duke na mbështetur me trajnime brenda dhe jashtë vendit, e gjithashtu edhe në aspektin logjistik ku ka dhënë një kontribut të madh". Gjenerali më pas theksoi edhe rolin e shteteve tjera anëtare të NATO-s, të cilat kanë treguar përkushtim për ngritjen e një force të aftë e profesionale siç është FSK-ja. Gjatë kësaj periudhe, vazhdoi gjeneral Cikaqi, KDS-ja ka bashkëpunuar me Grupin Luftarak Shumëkombësh Lindje (Bondsteel), të cilët kanë ofruar mbështetje me instruktorë për realizimin e trajnimeve aty ku kemi pas mungesa dhe programe të cilat kemi arrit që t'i adaptojmë për nevojat e FSK-së, pohoi në ligjëratën e tij gjeneral Cikaqi. Gjithashtu, gjatë prezantimit, gjenerali foli edhe për të ardhmen e Forcave të Armatosura të Kosovës si një vazhdimësi e historisë së institucionit të uniformuar dhe trajnuar në mënyrë të specializuar në të gjitha lëmit ushtarake. Ushtria amerikane është partner strategjik i FSK-së tash, besoj se kështu do të jetë edhe në të ardhmen, atëherë kur të jemi Forca të Armatosur të Kosovës, dhe besojmë që Kosova së shpejti do të jetë vend kontribues i paqes dhe jo vetëm konsumues i saj.

Komandanti i Bondstillit, kolonel Clinton Baker falënderoi komandantin e KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqin për kontributin e tij me këtë ligjëratë para ushtarakëve amerikanë, ndërsa audienca e mirëpriti ligjëratën e komandantit të KDS-së, dhe në fund u shtruan një varg pyetjesh të cilave gjenerali iu përgjigj.Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe Grupi Luftarak Shumëkombësh Lindje (Bondsteel) vazhdojnë të zhvillojnë një bashkëpunim të shkëlqyer në shumë fusha me interes të përbashkët.

FSK-ja në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën"

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Ferid Agani, pjesëtarë të FSK-së, nxënës të shkollave fillore të Prishtinës dhe qytetarë-vullnetarë të tjerë, si dhe përfaqësues të shoqatave joqeveritare morën pjesë në aksionin "Ta Pastrojmë Kosovën", në lagjen "Arbëria 3" të Prishtinës, të organizuar nga Iniciativa "Ta Pastrojmë Kosovën". Komandantit i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahaman Rama, me këtë rast, përshëndeti pjesëmarrësit e aksionit për pastrimin e ambientit, nxënësit e shkollave fillore, ushtarët e FSK-së dhe qytetarët e Kosovës. Ai gjatë fjalimit të tij ndër të tjera tha: "Këtë aktivitet e kemi bërë tashmë tradicional në gjithë Kosovën. Sot, po marrim pjesë dhe po kontribuojmë sado pak në pastrimin e ambientit sepse është në të mirën e qytetarëve, në të mirën e fëmijëve tanë dhe pasardhësve tanë" -tha në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Ndërsa, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferid Agani, me këtë rast theksoi:"Është një thënie që mjedisi është pasqyra jonë, unë jam i bindur që fytyra jonë nuk është kjo që po e shohim përreth dhe përfundimisht duhet bërë atë që e bënë çdo njeri në mjedisin ku jeton. Kjo sot që po e shohim është një dëshmi e fuqisë së qytetarisë së Kosovës, e rinisë së Kosovës dhe kjo më bënë shumë optimist që në ditët e ardhshme do ta kemi shtetin tonë ashtu siç jemi vet".





Edhe koordinatori i Iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën", Luan Hasanaj tha: "Jemi sot këtu për ta hapur aksionin "Ta pastrojmë Kosovën" së bashku me ministrin e mjedisit, gjeneralin e FSK-së dhe kryetarin e Green Art Center, dhe me ata që më së shumti i kontribuojnë këtij aksioni që janë këta 500 fëmijë vullnetarë që edhe në këtë ditë me shi, po i bashkohen aksionit për largimin e mbeturinave. Presim mbi 50 mijë vullnetarë që të jenë sot në aksion dhe shpresojmë që përfundimisht duhet ta ndërrojmë qasjen ndaj mjedisit. Si qytetarët, institucionet dhe shoqëria civile duhet të bashkëpunojnë dhe përfundimisht mjedisi jonë të duket ashtu si i ka hije. Në këtë aksion, këtu në Prishtinë, po marrin pjesë mbi 500 fëmijë së bashku me pjesëtarë të FSK-së. Aksioni për pastrimin e ambientit po zhvillohet në njëjtën kohë në gjithë territorin e Kosovës"

FSK-ja në këtë aksion i cili u zhvillua anë e këndë Kosovës si në Prishtinë, Istog, Shkabaj, Ferizaj, Mitrovicë, Liqeni i Badovcit etj., mori pjesë me një numër të caktuar ushtarësh dhe me dhjetëra automjete si kamionë dhe ekskavatorë.



Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama homazhe në nderim të dëshmorit Luan Haradinaj

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Shkëlzen Sylaj, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtor i Drejtorisë për Operacione dhe Trajnime në MFSK, kolonel Naim Haziri shef i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore si dhe oficerë dhe zyrtarë të MFSK-së dhe FSK-së, në përvjetorin e 18 të rënies së dëshmorit të kombit Luan Haradinaj sot ishin në Deçan. Ata bënë homazhe dhe vendosën lule të freskëta në shenjë nderimi dhe përkujtimi të luftës heroike të dëshmorit luan Haradinaj si dhe të gjithë dëshmorëve të kombit.

Shefi i Shtabit të Komandës Tokësore të FSK-së, kolonel Naim Haziri priti një delegacion të Forcave të Armatosura të Shqipërisë

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, koloneli Naim Haziri së bashku me bashkëpunëtorë, priti një delegacion të oficerëve të lartë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të prirë nga nënkolonel Ulsi Rexhaj, komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), nënkolonel Lutfi Shahini, nënkolonel Nexhmi Vrenezi, nënkolonel Isuf Lushaj dhe kapiten Edvin Nure. Delegacioni i FARSH-it po qëndron për në një vizitë pune në MFSK/FSK, ku po punon rreth zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara në fushën e ndërlidhjes FARSH-FSK, për vitin 2015. Shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Haziri e njoftoi delegacionin e FARSH-i me të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Ai, mes tjerash gjatë takimit tha: "Ndihma e FARSH është e pakursyer në të gjitha fushat drejt realizimit të misionit tonë si shtet dhe si Forcë e Sigurisë, duke shkuar drejt anëtarësimit tonë në strukturat veriatlantike. Eksperienca dhe rruga e juaj drejt anëtarësimit në NATO do të na ndihmojë shumë në plotësimin e standardëve të cilat kërkohen për anëtarësim në këto instanca",- tha shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Haziri.

Oficerët e FARSH-it punuan edhe në ngritjen e rrjetit të komunikimit. Në fund, kolonel Haziri falënderoi oficerët e FARSH-it, për kontributin e dhënë në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së në të gjitha fushat.




FSK-ja dhe Ushtria e SHBA-ve zhvilluan stërvitje të përbashkët

Brigada për Reagim të Shpejtë dhe njësitë tjera të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim dhe asistencë të Ushtrisë amerikane për Evropë dhe Komandës amerikane për Evropë zhvilluan me sukses stërvitjen e përbashkët ,,Ndihma e Kosovës", në Aeroportin fushor të Gjakovës.

Aktivitetet e operacionit i pa nga afër edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i cili me këtë rast i përgëzoi udhëheqësit e operacioneve dhe pjesëtarët që në mënyrë profesionale realizuan të gjitha pjesët e skenarit të ushtrimit.

Gjithashtu, gjeneral Rama tha se FSK-ja për here të parë është stërvitur për tërheqjen e ndihmave humanitare, për here të parë është stërvitur për manovrim të ndihmave të lëshuara nga ajri nëpërmjet aeroplanëve dhe helikopterëve, përvojë kjo e cila do t'i nevojitet, në raste emergjente kur kërkohet angazhim humanitar. Në fund komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, deklaroi se kjo stërvitje ka rëndësi sepse FSK-ja me këtë ushtrim është stërvitur për ndërveprim me Ushtrinë amerikane, por edhe për ndërveprime me partnerë dhe institucione tjera në raste emergjencash dhe atëherë kur paraqitet nevoja. Major Jason Waine, oficer për Operacione i Brigadës 40 të Parashutistëve, Divizioni i 25 i Këmbësorisë nga Alaska e ShBA-ve, njëherësh nga Ushtria amerikane për Evrope, e vlerësoi lartë bashkëpunimin ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë amerikane për Evropë. Ai tha se Forcat Ajrore amerikane kanë ardhur sot këtu nga Gjermania dhe kanë lëshuar pakot si pjesë e ushtrimit. Ky demonstrim me aeroplanët e tipit C130J ka treguar se ndërveprimi ndërmjet dy partnerëve ishte i shkëlqyer dhe se Forca e Sigurisë së Kosovës është mjaft profesionale.









Qëllimi i ushtrimit ,,Ndihma e Kosovës" ka qenë që FSK-ja të trajnohet në mënyrë që të asistojë autoritetet civile gjatë emergjencave dhe fatkeqësive natyrore apo emergjencave tjera që kërkojnë asistencë humanitare.

Në këtë ushtrim për herë të parë u përdorën për qëllime ushtrimi aeroplanë të Forcave Ajrore amerikane të tipit C130J, të cilët nga Ramshtajni i Gjermanisë fluturuan për në Aeroportin e Gjakovës. Ushtrimi u realizua nga Forca e Sigurisë së Kosovës e cila udhëhoqi me ushtrimin dhe u zhvillua me asistimin e Brigadës së Katërt të Këmbësorisë Parashutiste Luftarake nga Alaska e Shteteve të Bashkuara të Amerikës(ShBA), aktualisht e bashkangjitur Ushtrisë amerikane për Evropë, si dhe Komandës së SHBA-ve për Evropë(UECOM).

Roli i Ushtrisë amerikane për Evropë në këtë ushtrim ishte; asistencë në planifikim, burime trajnuese dhe ekspertizë teknike. Të pranishëm gjatë zhvillimit të ushtrimit; ,, Ndihma e Kosovës", ishin të pranishëm, zëvendësministri Fadil Gashi, Ud/komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, komandanti i Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë, nënkolonel Mehmet Lladrovci si dhe oficerë të tjerë të lartë të FSK-së dhe Ushtrisë amerikane për Evropë.









Ushtrim i përbashkët i Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së me KFOR-in amerikan



Në Kampin e Kontingjentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në kuadër të KFOR-it, në "Bondsteel" të Ferizajt, e përfunduan Ushtrimin për Repelim 42 kadetë të Qendrës së Studimeve Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Stafi i QSU-së së bashku me KFOR-in amerikan mbajtën një ushtrim për teknikat dhe taktikat e Repelimit, duke kryer stërvitje në poligone dhe ambiente të përshtatshme për këtë lëmi. Qëllimi i këtij ushtrimi ishte përgatitja e kadetëve të QSU-së, që pas diplomimit të kenë njohuri të mjaftueshme për realizimin e misionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë mbajtjes së këtij ushtrimi kadetët e QSU-së demonstruan nivel të lartë të profesionalizmit dhe të përgatitjeve fizike, gjë që u vlerësua lartë nga instruktorët e Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Pomozotin të cilët e realizuan ushtrimin.

Ky ushtrim ishte rezultat bashkëpunimit që ka QSU-ja me Ushtrinë e Amerikës në Kosovë.

FSK në Garën për zgjedhjen e ushtarit më të mirë në Kroaci

Për herë të parë Forca e Sigurisë të Kosovës mori pjesë dhe përfundoi me sukses Garën për zgjedhjen e ushtarin më të mirë të Forcave të Armatosura të Kroacisë. Garat u mbajtën në zonën e trajnimit ushtarak "Eugen Kvaternik" në Slunj të Kroacisë veriore. FSK-në e përfaqësuan Tetarët Binak Podrimçaku dhe Feti Pronaj së bashku me 151 pjesëmarrës të tjerë nga 10 shtete të ndryshme të botës. Gara është mbajtur në periudhën prej dy ditësh, 20 dhe 21 maj, si dhe përfshiu përfundimin e kursit prej 46 kilometrave mbi terrenin sfidues dhe kalimin e 13 pengesave në shteg. Gara ishte dizajnuar të demonstrohen përgatitjet individuale, njohuritë ushtarake, shkathtësitë individuale, si dhe përgatitja fizike dhe mentale. As kushtet e vështira atmosferike përgjatë garës, nuk ndalën paraqitjen e jashtëzakonisht të pjesëmarrësve të FSK-së, të cilët arritën ta përfundojnë me sukses dhe të jenë në mesin e më të mirëve, ku Tetari Feti Pronaj u rendit i 4-ti, nga pjesëmarrësit ndërkombëtarët, duke e pasur parasysh se gjysma e pjesëmarrësve nuk arritën ta përfundojnë garën. "Kjo ishte një ngjarje e shkëlqyeshme për pjesëtarët e FSK-së, sepse gati gjysma e të gjithë pjesëmarrësve nuk e përfunduan garën" tha nënkolonel David Jones, këshilltar i Komandantit të FSK-së, i cili ndër të tjera shtoi " Unë, me të vërtetë jam krenar për përpjekjet e pjesëtarëve të FSK-së si dhe të dy pjesëmarrësve të cilët, vërtetë dolën mirë. Kjo ishte për shkak të profesionalizmit, përkatshmit dhe shpirtit ekipor të individit" theksoi në fund, nënkolonel David Jones.



Në FSK u mbajtën garat për zgjedhjen e ushtarit më të mirë

Migjen Shala, ushtari më i mirë i FSK-së, për vitin 2015''



Në një ceremoni solemne të organizuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama ndau çmimin ,,Ushtari më i mirë në FSK për vitin 2015", i cili çmim për këtë vit i takoi ushtarit Migjen Shala. Aktiviteti i shpalljes së rezultateve të garës për ,,Ushtarin më të mirë 2015", u mbajt në Komandën e Brigadës për Mbështetje Operacionale, me ç'rast u ndanë tri çmimet e para dhe me nga një mirënjohje u nderuan të gjithë garuesit. Në ceremoni morën pjesë oficerë të lartë të FSK-së, si dhe oficerë dhe nënoficerë ndërkombëtarë. Në fjalën e tij të rastit gjeneral Rama u shpreh se ndjehet tejet i lumtur që ushtarët të cilët kanë garuar gjatë këtyre ditëve kanë treguar profesionalizëm, përkushtim dhe njohuri shumë të mira të shkathtësive ushtarake. Komandant Rama më tej shtoj: ,, Bazuar në rezultatet e arritura mund të them se ne të gjithë jemi fitues, e gjithashtu Ju keni dëshmuar që ne si forcë e re jemi në rrugë të mirë të ngritjes së kapaciteteve tona dhe ushtarët tanë janë të përgatitur, të motivuar dhe të gatshëm të marrin përgjegjësi të reja." Në vazhdim, gjenerallejtënant Rrahman Rama iu drejtua ushtarëve që sfiduan këtë garë me këto fjalë: ,,Ushtarë të nderuar, ju me përkushtimin e dhënë gjatë kësaj gare jeni bërë shembull për të gjithë ushtarët e tjerë. Gjithashtu, ju keni vendosur standarde të larta për të gjithë ushtarët e tjerë." Në fund të fjalës së tij, gjeneral Rama tha: ,,Vetëm kështu, duke i ngritur standardet ne ecim drejt përmirësimit dhe zhvillimit të forcës. Jam i bindur që ky shpirt garues do të vazhdojë të rritet dhe përcillet tek gjeneratat e reja që do të vijnë pas jush.' Në aktivitetin solemn me rastin e shpalljes së rezultateve të garës: ,,Ushtari më i mirë 2015", foli edhe rreshter majori i FSK-së Genc Metaj, i cili së bashku me rreshterët e brigadave dhe njësive ishte i angazhuar gjatë gjithë kohës së zhvillimit të garës në njësi, brigada dhe në fund në nivel të FSK-së. Rreshteri Metaj tha se ndjehet i lumtur që gara e vitit 2015 ka shkuar mbarë dhe se rezultatet e arritura sot po prezantohen këtu para të gjithë eprorëve dhe se kjo garë është motivim për ushtarakët e FSK-së.

Në fund të ceremonisë u shpallën edhe emrat e fituesve të garës, ku në vendin e parë sipas rezultateve të arritura në të gjitha disiplinat u përzgjodh ushtari Migjen Shala nga Brigada për Mbështetje Operacionale, në vendin e dytë ushtari Besnik Nebihu nga po e njëjta brigadë, kurse vendi i tretë i takoi Elvis Hasanajt nga Brigada e Reagimit të Shpejtë.

Çmimet kryesore i ndanë komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, atasheu ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës(ShBA), kolonel Chad Batts dhe rreshter majori i FSK-së Genc Metaj. Gjithashtu të 22 ushtarët garues nga të gjitha brigadat e FSK-së u nderuan me nga një mirënjohje për pjesëmarrje. Për tri ditë me radhë 22 pjesëtarë të përzgjedhur të të gjitha njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës (Komandës së Forcave Tokësore, Brigadës për Reagim të Shpejtë, Brigadës për Mbështetje Operacionale dhe Komandë së Doktrinës dhe Stërvitjes), garuan dhe sipas rezultateve të tyre të arritura pritet që të shpallet ushtari më i mirë.

Ushtarët u testuan në këto lëmi: Navigim tokësor (ditën dhe natën), gjuajtja me armë të gjata, test fizik, kalimi i poligonit me pengesa, test me shkrim në njohuri të përgjithshme ushtarake, marshim në distancë të gjatë me ngarkesë etj.Gara e FSK-së për ushtarin më të mirë është organizuar për herë të dytë në FSK. Garën e vitit të kaluar e pati fitar tetar Binak Podrimqaku, i cili në këtë muaj do të marrë pjesë në garën ndërkombëtare të ushtarëve më të mirë që do të mbahet në Republikën e Kroacisë.

Pjesëtarë të FSK-së certifikohen në kursin "Sistemi i Informimit Gjeografik"

Në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, 21 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë të Kosovës kryen kursin "Sistemi i Informimit Gjeografik".

Me këtë rast shef i Shtabit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Fadil Hadërgjonaj, tha: "Pas shumë përpjekjesh dhe angazhimesh arritëm që ta fusim në funksion këtë kurs i cili është realizuar falë angazhimit të instruktorëve të QSK-së, të cilët me përkushtim të lartë kanë punuar gjatë tërë javës sa ka zgjatur kursi. Ndërsa motivimi i pjesëtarëve të FSK-së është për t'u admiruar, ka qenë një përkushtim dhe disiplinë e lartë nga ana e tyre. Ky program do t'i shërbejë FSK-së shumë në të ardhmen. Ne do të bëjmë përpjekje që ta avancojmë edhe më shumë, por e rëndësishme është që pjesëtarët të cilët e kanë vijuar këtë kurs vijnë nga njësi të ndryshme të FSK-së dhe kanë mundësi që njohuritë e marra t'i shpërndajnë te kolegët e tyre dhe kështu kursi do ta ketë efektin e plotë". Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel NaimHaziri, kolonel Skënder Hoxha nga Ministria e FSK-së, shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Fadil Hadërgjonaj si dhe oficerë tjerë të FSK-së. Ndërsa komandanti i QSK-së, major Naim Sylejmani, lidhur me rëndësinë e këtij kursi u shpreh: "Ky kurs i ka të veçantat e tij për shkak se po realizohet për herë të parë në FSK, duke zbatuar programin e zhvilluar të teknologjisë informative me tendencë të zhvillimit dhe avancimit të këtij programi".

Në fund kolonelët Naim Haziri, Fadil Hadergjonaj, Bashkim Shillova dhe major Naim Sylejmani ndanë certifikata për të gjithë pjesëtarët e FSK-së të cilët ishin pjesëmarrës të kursit Sistemi i Informimit Gjeografik.







Konferenca Ndërkombëtare "Kosova dhe fqinjët në perspektiven e integrimeve Euro-Atlantike...

Kolonel Ilir Qeriqi mbajti kumtesën Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe sfidat e integrimit të FSK-së në NATO

Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), kolonel Ilir Qeriqi mori pjesë në Konferencën "Kosova dhe fqinjët në perspektiven e integrimeve Euro-Atlantike, bashkëpunimi regjional dhe sfidat e sigurisë", organizuar nga Akademia Diplomatike e Kosovës, mbajtur në Pejë. Kolonel Qeriqi, në Konferencën për Kosovën dhe fqinjët, ishte njëri ndër panelistët dhe mbajti kumtesën, me temën: "Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal dhe sfidat e integrimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës". Me këtë rast të pranishmit janë njoftuar me fushat e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal të FSK-së me shtetet partnere me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të FSK-së dhe sfidat me të cilat FSK po përballet në rrugën për integrim në strukturat Euro-Atlantike. Kjo konferencë ishte një mundësi e mirë për të diskutuar me diplomatët rreth qasjeve të tyre për temat e shtjelluara si dhe një mundësi e mirë për të dëgjuar perspektiven e ligjëruesve me provojë, siç ishin: Rouse, Marie Dicarlo-ish ambasadore e SHBA-ve në OKB, Wolfan Petriq, diplomat i njohur, si dhe ligjërues të tjerë nga Marshal Center dhe nga Akademi Diplomatike Eminente. Kolonel Qeriqi theksoj, se "Konferenca "Kosova dhe fqinjët në perspektiven e integrimeve Euro-Atlantike, bashkëpunimi regjional dhe sfidat e sigurisë" është shumë e rëndësishme pasi që janë debatuar dhe mbajtur kumtesa për këndvështrime të ndryshme në lidhje me sfidat e bashkëpunimit rajonal dhe Euro-Atlantike, si dhe objektivat e sigurisë së NATO-s. Në këto rrethana operacionet dhe veprimet e operimit në një mjedis të pasigurt dhe kompleks duhet të kenë një qasje gjithëpërfshirëse-DIME (Diplomatike, Informacione, Ushtarake, Ekonomike), që mund të ndihmojnë në këtë situatë të ndërlikuar dhe të pashembullt të sigurisë. Kumtesa e kolonel Qeriqit e prezantuar para diplomatëve të rinj gjatë konferencës u ndoqën me interesim të veçantë edhe për shkak të aktualitetit tematik por edhe për mënyrën si u prezantuar nga ligjëruesi duke zbatuar forma të angazhimit interaktiv të pjesëmarrësve. Në Konferencë morën pjesë edhe diplomatë nga Shqipëra, Bullgaria, Hungaria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Turqia etj, si dhe diplomatë e zyrtarë të lartë të Kosovës. Nga FSK-ja, morën pjesë diplomatët e rinj, kolonel Xhavit Sadrija, atashe i FSK-së në Gjermani, nënkolonel Enver Dugolli, atashe në Shqipëri, nënkolonel Ahmet Ajeti atashe në Bruksel, major Sefer Shyti atashe në Suedi dhe nënkolonel Bekim Osmani atashe në Turqi. Në fund, pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata përkatëse të cilat u shpërndanë në mënyrë solemne.

Instruktorët e FSK-së u certifikuan nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit "Hasan Prishtina"



Në ambientet e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës(UP), në një ceremoni të veçantë u krye certifikimi i 25 instruktorëve të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës. N ë aktivitetin e ndarjes së certifikatave si rezultat i përfundimit të trajnimit tremujor me tematikë; "Qasja didaktike në punën me të rritur' morën pjesë: komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi, rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Ramadan Zejnullahu, dekani i Fakultetit të Edukimit, Ethem Çeku, nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Drita Kadriu, profesor dhe studentë të Fakultetit të Edukimit si dhe oficerë dhe nënoficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, gjeneral Enver Cikaqi në emër të KDS-së dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës falënderoi rektorin Zejnullahu, dekanët Çeku dhe Veselaj si dhe tërë stafin akademik të Fakultetit të Edukimit për punën e pakursyer në të mirë të përfundimit me sukses të trajnimit tremujor për instruktorët e FSK-së. Më tej gjeneral Cikaqi tha se ky trajnim do të shërbejë që instruktorët e FSK-së të kenë mundësi që metodat e reja didaktike t'i aplikojnë gjatë trajnimeve dhe punës me pjesëtarët e FSK-së. Komandanti i KDS-së në fund të fjalës së tij tha gjithashtu se bashkëpunimi në mes Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së dhe Fakultetit të Edukimit të UP-së është i një rëndësie të veçantë dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Nga ana e tij rektori i Universitetit të Prishtinës ,, Hasan Prishtina", prof, dr. Ramadan Zejnullahu u shpreh se ndjehet tejet i lumtur që Universiteti i Prishtinës ka ofruar këtë program për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe u zotua se institucioni që ai drejton është i hapur për bashkëpunim edhe në të ardhmen. Gjithashtu, në ceremoninë e certifikimit të instruktorëve foli edhe dekani i Fakultetit të Edukimit, Ethem Çeku i cili tha se Fakulteti i Edukimit dhe ai personalisht e kanë për nderë që gjatë kësaj periudhe sa ka zgjatur trajnimi, por edhe në raste tjera, të punojnë ngushtë me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Dekani Çeku tha gjithashtu se fakulteti që ai drejton është i gatshëm të bashkëpunojë edhe në të ardhmen.

Në fund të ceremonisë, rektori Zejnullahu dhe dekani Çeku ndanë certifikata për 25 pjesëtarët e FSK-së të cilët punojnë si instruktorë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, e të cilët për tre muaj ndoqën këtë trajnim. Pastaj, gjeneral Enver Cikaqi në emër të KDS-së dhe FSK-së, për realizuesit e këtij projekti, ndau nga një mirënjohje në shenjë respekti për kontributin e pedagogëve gjatë gjithë kursit. Trajnimi ,,Qasja didaktike në punë me të rritur" ka zgjat tre muaj dhe gjatë kësaj kohe janë trajtuar temat si:,, Modalitetet e vlerësimit në teori dhe në praktikë", "Aspektet psikologjike të vlerësimit", ,,Strategji bashkëkohore të mësimdhënies" etj. Të 25 instruktorët e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, me këtë trajnim kanë përfituar njohuri të reja për punën e tyre të përditshme për realizimin me sukses të kurseve dhe trajnimeve në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Batalioni i Xhenios i FSK-së me projekte të rëndësishme në shërbim të qytetarëve



Batalioni i Xhenios i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) të FSK-së, këto ditë, është angazhuar në realizimin e dy projekteve të ndryshme, në atë të tërheqjes së urës në fshatin Kramovik të Klinës dhe largimin e telave gjemborë nga rrethoja e Kishës Ortodokse në Prizren.



Pjesëtarët e Batalionit të Xhenios, urën mobile, e cila është pronë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me një gjatësi prej 52 metrash dhe me peshë mbi 75 tonelata, qysh në muajin korrik të vitit 2013 e patën montuar mbi lumin "Drini i Bardhë" në aksin rrugor Gjakovë-Klinë, pas vërshimeve të cilat e patën dëmtuar urën kryesore mbi këtë lumë. Që nga korriku i vitit 2013, ura e FSK-së ka shërbyer për të gjitha automjetet të cilat kanë kaluar aksin rrugor Gjakovë-Klinë dhe anasjelltas. Tani pas meremetimit të urës në rrugën kryesore dhe lëshimit të saj në qarkullim të automjeteve, ura mobile e FSK-së nuk është më funksionale. Për këtë, sipas planit dinamik të Brigadës së Mbështetjes Operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës, zhvendosja e saj ka filluar më 12 maj 2015 dhe pritet të përfundojë në një afat prej 12 ditësh, ku ura e çmontuar do të dërgohet në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, me qëllim që të jetë në gatishmëri të plotë në të ardhmen dhe të përdoret në shërbim të popullatës kudo që të ketë nevojë.

Në këtë operacion janë angazhuar gjithsej 27 pjesëtarë të Batalionit të Xhenios të Komandës dhe Doktrinës së Stërvitjes dhe të Batalionit të Mjekësisë. Ndërsa, në projektin e dytë, në atë të largimit të rrethojave gjembore nga Kisha Ortodokse në Prizren, që ka filluar të hënën më 18 maj, pritet të përfundojë të premten më 22 maj. Në këtë projekt po marrin pjesë 15 pjesëtarë të Batalionit të Xhenios me 5 automjete.

Në FSK u mbajt seminari ''Operacionet e stabilitetit''

Në repartet e Policisë së Forcës në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët vijuan seminarin me temë: ,,Operacionet e Stabilitetit". Ky seminar i zhvilloi punimet nga data 5 deri më 7 maj 2015 nën udhëheqjen e marinsave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij gjatë ceremonisë tha: ,,Forca e Sigurisë së Kosovës është duke punuar dhe do të vazhdojë të punojë dhe të bashkëpunojë me partnerët e saj strategjikë, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera". Gjeneral Rama tha gjithashtu se FSK-ja është duke u angazhuar që të krijojë një standard adekuat për ndërveprim në të



ardhmen, në mënyrë që në rastet kur merr ftesë për angazhime në operacione paqësore të jetë e gatshme. Ne, shtoi gjeneral Rama, asnjëherë nuk e harrojmë mbështetjen e vendeve demokratike për Kosovën, prandaj për këtë qëllim përgatitemi që me kapacitetet tona të japim kontributin që do të na kërkohej. Në fund të fjalës, gjeneral Rama i përgëzoi oficerët dhe nënoficerët e FSK-së për angazhimin dhe seriozitetin e treguar e gjithashtu edhe për shkathtësitë profesionale të paraqitura në këtë seminar. Po ashtu , komandanti i FSK-së, në veçanti i falënderoi ushtarakët e Marinës të SHBA-ve, kapitenin Ryan P. Behan dhe kapterin(Gy.Sgt) Patrick C.Cochrane, si dhe Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë, për kontributin e dhënë në mbarëvajtjen e seminarit dhe ndarjen e eksperiencave me oficerët dhe nënoficerët e FSK-së pjesëmarrës në këtë trajnim. Gjeneral Rama, në shenjë falënderimi, ndau mirënjohje për të dy ushtarakët e Marinës së SHBA-ve, të cilët për tri ditë punuan bashkërisht me oficerët e FSK-së në mbarëvajtjen e seminarit. Nga ana e tij, instruktori i marinsave amerikanë, kapiteni Ryan P. Behan tha se ndjehet i lumtur që FSK-ja ka oficerë kaq profesional dhe bashkëpunues, dhe se gjatë gjithë seminarit ne tha kapiten Behani kemi shkëmbyer përvoja, kemi treguar eksperiencat tona nga fusha e operacioneve të stabilitetit si dhe kemi marrë shumë njohuri edhe nga përvoja e oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së. Për përfundimin me sukses të seminarit, për 30 oficerë të shtabeve dhe nënoficerë të FSK-së u ndan certifikata.

Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm edhe atasheu i Mbrojtjes i SHBA-ve pranë Ambasadës amerikane, kolonel Chad Butts, kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK etj. Bashkëpunimi i mirë në fushën e trajnimeve dhe profesionalizimeve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës po avancohet çdo ditë e më shumë, bashkëpunim ky i cili po zhvillohet suksesshëm në koordinim me Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë dhe përfaqësuesit ushtarak amerikan të angazhuar pranë saj.

Brigada e Reagimit të Shpejtë realizoi ushtrimin ''Ujku Garues 2015''

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, për herë të parë u mbajt ushtrimi "Ujku Garues 2015", në nivel të BRSH-së, ku garuesit u sfiduan në shkathtësitë profesionale dhe fizike. Në këtë ushtrim morën pjesë gjithsej 50 pjesëtarë; një ekip nga Komanda e BRSH-së dhe nga tri ekipe të Batalioneve 1, 2 dhe 3 të BRSH-së. Disiplinat në të cilat u sfiduan garuesit ishin: vrapimi 3.2 km, hedhja e granatës së dorës, shtyrja e autoblindës, vëzhgimi, kalimi i zonave të minuara dhe kalimi mbi zona të rrezikshme.

Në përcjellje të ushtrimit ishin prezent edhe ushtruesi i detyrës së Komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, komandanti i Batalionit 2-të të Reagimit të Shpejtë nënkolonel Mehmet Lladrovci, ushtruesi i detyrës së shefit të Shtabit të BRSH-së, major Ejup Maqedonci, stafi i komandës së BRSH-së dhe i tri batalioneve. Kolonel Geci, me rastin e adresimit të pranishmëve dhe pjesëmarrësve në garë, ndër të tjera tha: "Përgatitja e pjesëtarëve të BRSH-së në ngritjen e shkathtësive profesionale është domosdoshmëri dhe kusht që, ne, si Brigadë e Reagimit të Shpejtë të jemi në nivelet më të larta të përgatitjes profesionale".

Synimi kryesor i organizimit të kësaj gare, nga Shefi i Shtabit të BRSH-së, major Ejup Maqedonci dhe rreshter majori i parë Shefqet Hasani ishte që pjesëtarët e BRSH-






së të sfidoheshin në disiplinat e lartcekura në mënyrë që të dëshmonin përgatitjen fizike dhe mentale. E gjithashtu, kjo garë është realizuar me qëllim të motivimit të pjesëtarëve të BRSH-së për ngritjen e vazhdueshme të shkathtësive profesionale me qëllim që Brigada e Reagimit të Shpejtë të jetë më e përgatitur profesionalisht që t'i shërbejë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në fund të ushtrimit "Ujku Garues 2015", në bazë të rezultateve të arritura; vendin e parë e zuri Ekipi i 3-të i Batalioni të Parë të Reagimit të Shpejtë, (RSH), vendin e dytë Ekipi i 2-të i Batalionit të Parë të RSH, dhe në vendin e tretë u rendit, Ekipi i 3-të i Batalionit të Tretë të RSH. Vendi i parë u shpërblye me Emblemën e BRSH-së dhe Mirënjohje, ndërsa vendi i dytë dhe i tretë me Mirënjohje.

U certifikuan pjesëmarrësit e trajnimit ''Taktika me njësitë e vogla''

Në Brigadën për Reagim të Shpejtë në kazermën e FSK-së,,Ushtarët e NATO-s" në Istog, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama bëri një vizitë pune me rastin e ceremonisë së certifikimit të 50 pjesëtarëve të gjeneratës së dytë, të cilët përfunduan me sukses trajnimin pesë javor ,,Taktika me njësitë e vogla". Duke ju drejtuar ushtarëve të certifikuar komandant Rama ndër të tjera tha se ushtarët dhe nënoficerët të cilët janë stërvitur gjatë këtij trajnimi



kanë treguar përkushtim dhe kanë marrë njohuri të reja në shkathtësitë ushtarake të nevojshme në njësitë e vogla". Duke vazhduar fjalën e tij më tej shtoi: ?Ju me këtë po dëshmoni që ne si forcë e re jemi në rrugë të mirë të ngritjes së kapaciteteve tona dhe pjesëtarët tanë janë të përgatitur, të motivuar dhe të gatshëm për të marrë përgjegjësi të reja?. Me këtë rast ai uroi dhe përgëzoi ushtarët për përfundimin me sukses të këtij trajnimi, po ashtu ai falënderoi dhe vlerësoi lartë edhe punën e instruktorëve dhe oficerëve drejtues të këtij trajnimi. Për pjesëtarët të cilët kanë përfunduar këtë trajnim u ndanë certifikata, kurse për më të dalluarit shpërblime, po ashtu me këtë rast u ndanë mirënjohje për instruktorët e këtij trajnimi.

Në ceremoni të pranishëm ishin edhe ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, ushtruesi i detyrës së shefit të Shtabit të BRSH-së, major Ejup Maqedonci, komandantët e tri Batalioneve të Reagimit të Shpejtë, përfaqësues nga Stacioni i Policisë në Istog, Drejtoria e Qendrës së Burgut të Dubravës, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Instruktorë të Forcave të Armatosura të Polonisë trajnojnë pjesëtarë të FSK-së

Në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, më 29 maj, u bë ceremonia e certifikimit të 16 pjesëtarëve të njësive të ndryshme të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), të cilët ndoqën një trajnimin tre ditor "Mësimet e mësuara" nga ekipi mobil i instruktorëve të Komandës Operacionale të Forcave të Armatosura të Polonisë. Me këtë rast, shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Naim Haziri, falënderoi Ekipin e Instruktorëve të Polonisë, për bashkëpunimin me FSK-në, për të shtuar se: "është shumë e rëndësishme për një institucion me i nda përvojat e përbashkëta për ne. Faleminderit juve, faleminderit shtetit tuaj dhe ushtrisë suaj, për mbështetjen e vazhdueshme që po jepni shtetit tonë dhe në veçanti Forcës së Sigurisë së Kosovës" Ndërsa, kolonel Zabek Zbignjev u shprehë shumë i kënaqur me bashkëpunimin në mes FSK-së dhe instruktorëve të Forcave të Armatosura të Polonisë. Ai, tha se: "ishte një bashkëpunim mjaft i mirë, ku shkëmbyem përvojat tona dhe sollëm praktikat tona për "mësimet e mësuara" sipas standardeve të NATO-s".



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republika of Kosovo
Qeveria - Vlada Guvernement

Ministria për Komunitete dhe Kthim të Kosovës
Ministarstvo za Zajednice i Povratak Kosova - Ministry for Communities and Returns of Kosovo

KONKURS
Për rekrutimin e kadetëve për vitin 2015/2016

Ministria për Komunitete dhe Kthim të Kosovës (MKKK) ndërmarrë ndërmarrje, në Bazë të Ligjit [illegible] dhe [illegible] nga Nenet [illegible] të Ligjit [illegible] të Kosovës, [illegible] [illegible] [illegible]

FORCA JONË

* * * Viti IV • Nr. 36 • Korrik 2015 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i MFSK-së Haki Demolli takoi sekretarin e Marinës Ushtarake të SHBA-ve Raj Mabus



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), zoti Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shefin e Kabinetit Xhevdet Halili, në ndërtesën e Qeverisë të Republikës së Kosovës, patën një takim pune me Sekretarin e Marinës Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotin Ray Mabus, i cili shoqërohej nga ambasadorja e SHBA-ve në Prishtinë, zonja Tracey Jacobson dhe atasheu ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë, kolonel Anthony Butts.

Gjatë takimit u bisedua edhe për bashkëpunimin dhe përkrahjen e pakursyer të cilën ja afron SHBA-ja, MFSK-së dhe FSK-së në zhvillimin dhe avancimin e saj. U konstatua se kjo përkrahje afrohet në formë të trajnimeve për FSK-në dhe në formë të donacioneve financiare dhe materiale për programet dhe projektet ushtarake, si dhe për këshillime profesionale. Po ashtu u diskutua edhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, pas përfundimit të të cilit u vlerësua se do të krijohet një forcë e armatosur e cila nuk do të paraqet kurrfarë kërcënimi për regjionin. Forcë kjo, që do të jetë e gatshme për të afruar kapacitete e veta për mbrojtjen dhe integritetin e vendit, si dhe do të jetë e hapur për të gjithë anëtarët e minoriteteve në Kosovë dhe do të ketë trajtim të drejtë të çështjes gjinore.

Gjermania premton mbështetje për FSK-në



Ministri i FSK-së Haki Demolli priti komisionarin për Forcat e Armatosura në Parlamentin e Gjermanisë Hans Peter Bartels

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), zotëri Haki Demolli priti në një takim pune komisionarin për Forcat e Armatosura në Parlamentin e Gjermanisë Dr. Hans Peter Bartels. Ministri Demolli, me këtë rast, falënderoi shtetin e Gjermanisë dhe popullin gjerman për kontributin e madh që kanë dhënë për Kosovën. Në mënyrë të veçantë, ai vlerësoi kontributin e ushtrisë së Gjermanisë në ngritjen e FSK-së, përmes bashkëpunimit të ngushtë dhe përkrahjes së vazhdueshme në trajnime dhe logjistikë. Ai po ashtu vlerësoi lartë angazhimin e këshilltarëve ushtarakë në kuadër të ekipeve të NATO-s, në MFSK dhe FSK. Ministri Demolli foli edhe për arritjet dhe angazhimet e FSK-së në kryerjen e detyrave që dalin nga misioni aktual, si dhe e njoftoi mysafirin nga Gjermania me procesin dhe angazhimet që po bëhen për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Komisionari i Parlamentit Gjerman për Forcat e Armatosura, z. Hans - Petel Bartels, në fjalën e tij, shprehu konsideratën për arritjet e deritashme të FSK-së, si dhe premtoi vazhdimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët në mes Ushtrisë Gjermane dhe FSK-së. Në takim morën pjesë edhe zëvendësministri i MFSK-së, z. Fadil Gashi, shefi i Kabinetit të Ministrit, z. Xhevdet Halili, shefi i Ekpit Këshillues të NATO-s, z Domenik Brajtvajt dhe këshilltari politik Avdulla Shasivari. Ndërsa, komisionari nga Gjermania shoqërohej nga i ngarkuari me punë i Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë, zoti Mathias Kisler, gjeneral brigade Verner Haufman-drejtor i Ekipit Ndërlidhës të NATO-s në FSK, si dhe zyrtarë të tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë.

U mbajt Konferenca; Perspektiva e Ndërtimit të Integritetit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës sot u mbajt Konferenca; Perspektiva e Ndërtimit të Integritetit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ku morën pjesë ministri i MFSK-së z.Haki Demolli, zëvendës ministrat: Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, ambasadorë, atashetë, këshilltarë të NATO-s, dhe NLAT-it në MFSK, përfaqësues të Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Ministrisë së Norvegjisë, drejtorët e Drejtorive dhe Departamenteve të MFSK-së si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Konferenca është mbajtur në përkrahje të plotë të Ministrisë së Mbrojtjes të Norvegjisë dhe Qendrës Kosovare të Studimeve të Sigurisë (QKSS).

Konferencën e hapi ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli, i cili



pasi përshëndeti pjesëmarrësit, falënderoi në veçanti Qeverinë e Norvegjisë e cila po ndihmon Ministrinë e FSK-së, me projekte për ngritjen dhe fuqizimin e integritetit në MFSK. "Jemi të kënaqur që Mbretëria e Norvegjisë si një shtet mik i Republikës së Kosovës po vazhdon të afrojë asistencën dhe mbështetjen e saj në proceset e shtet-formimit në Kosovë, përfshirë edhe sektorin e sigurisë".

Vijon në faqen 7

Konferenca e tretë e ambasadorëve të Kosovës

Ministri i FSK-së i informoi diplomatët e Kosovës për transformimin e FSK-së dhe integrimin në NATO

Në ditën e dytë të Konferencës së Tretë të ambasadorëve të Republikës së Kosovës, më 26 qershor 2015, ministri i Forcës për Sigurinë e Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli e informoi stafin diplomatik të Kosovës, me procesin e transformimit të FSK-së dhe integrimin në NATO. Z. Demolli pos tjerash, në konferencë, tha: "Konform rekomandimeve, Ministria e FSK-së, ka hartuar draft ligjin për hartimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, të cilin draft ligj, ne si Ministri e kemi dorëzuar në muajin Mars në Qeverinë e Kosovës, dhe jemi në pritje të procedimit të tij në Kuvendin e Kosovës, ku pritet aprovimi i amendamenteve kushtetuese në të cilat do të bëhen ndryshimet kushtetuese të cilat kanë të bëjnë me këtë proces të transformimit".

Ai, gjithashtu, i njoftoi diplomatët për misionin që do ta kenë Forcat e Armatosura të Kosovës. " Misioni i FAK-ut, do të jetë mbrojtja e integritetit territorial të Kosovës, afrimi i përkrahjes për autoritetet civile në situatat emergjente dhe të jashtëzakonshme, si dhe pjesëmarrja në misione të ndryshme ndërkombëtare, qofshin ato paqeruajtëse apo humanitare". Ministri Demolli, për praktikat e integrimeve Evro-Atlantike dhe sfidat e Republikës së Kosovës për anëtarësim në NATO-s, tha: "Republika e Kosovës aspiron anëtarësimin e saj në NATO, jemi deklaruar pro marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, për të qenë një faktor konstruktiv në ndërtimin e paqes rajonale, sigurisë, stabilitetit dhe prosperitet ekonomik. Republika e Kosovës është në pritje të institucionalizimit të marrëdhënieve me NATO-n, më konkretisht deri më tani KFOR-in dhe dy ekipet këshilluese të NATO-s, që bashkëveprojnë me Ministrinë e FSK-së; NAT, (Ekipi Këshillues i NATO-s) NLAT (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s) janë mekanizmat kryesorë të cilët kanë ndërmjetësuar në bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet NATO-s dhe MFSK-së. Sa i përket bashkëpunimit dypalësh, ministri Demolli, tha se, MFSK-ja në rrafshin bilateral ka bashkëpunim me 11 shtete si dhe potencoi se "jemi në proces të nënshkrimit edhe të marrëveshjeve tjera, me shtete të rajonit dhe më gjerë". Ndërsa, për programin e partneritet shtetëror me Ajovën, Ai tha: "është forcuar bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes me SHBA-të dhe është e pakontestueshme se pikërisht SHBA-të janë kontribuuesit kryesor në ndihmën dhe përkrahjen e FSK-së, në fushën e edukimit dhe të trajnimit



të oficerëve dhe nënoficerëve, po ashtu edhe në fusha të tjera". Ndërsa, pos Shqipërisë që kemi nënshkruar marrëveshjen "Sofa", pritet, që edhe me Republikën e Maqedoninë ta nënshkruajmë këtë marrëveshje. MFSK po merr pjesë në shumë konferenca regjionale të sigurisë, siç janë "Karta e Adriatikut", etj. Ministri Demolli më tej theksoi se, "Ministria e FSK-së ka bërë hapat e parë në krijimin e rrjetit të diplomacisë në fushën e mbrojtjes dhe në nivelin bashkëpunimit dypalësh kemi 6 atashe, ndërsa në të ardhmen planifikohen të dërgojmë atashe edhe në disa vende të tjera, që janë me interes të përgjithshëm". "Ne me KFOR-in bashkëpunojmë edhe në fushën e sigurisë edhe në atë të trajnimeve, ku qëllimi dhe synimi ynë përfundimtar është anëtarësimi në mekanizmat e NATO-s"- shtoi në fund, ministri i MFSK-së, zoti Haki Demolli.

Ministri FSK-së Haki Demolli priti komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralin Timothy Orr



Sot, në ambientet e MFSK-së, ministri Demolli priti në takim komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës (GKA), gjeneralin Timothy Orr, të shoqëruar nga koloneli Anthony Butts, atashe ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë dhe koloneli Thoms Staton, këshilltar i Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK. Ministri Demolli falënderoi komandantin Orr, për kontributin e madh që ka dhënë SHBA-ja për Kosovën dhe veçanërisht shteti i Ajovës përmes programit të 'Partneritetit për Paqe'. Marrëveshja e bashkëpunimit përmes programit të 'Partneritetit për Paqe', ka vetëm një përfitues e ai është Kosova, konkretisht FSK-ja. Ministri Demolli e vlerësoi lartë bashkëpunimin e mirë dhe shumë intensiv në mes të GKA dhe FSK-së, në fushat e posaçme si; trajnime, shkollim, donacion, programe të posaçme dhe këshillime. Po ashtu edhe në fazën e transformimit të FSK-së në FAK, ndihma e Gardës Kombëtare të Ajovës është shumë e dobishme. Komandanti Orr, nga ana e tij, u shpreh se ndjehet shumë krenarë me marrëveshjen e bashkëpunimit të "Partneritetit për Paqe" mes Gardës Kombëtare të Ajovës dhe FSK-së, dhe këtë bashkëpunim e vlerëson prej partneriteteve më të suksesshme. Ai tha së është i kënaqur me punën dhe përparimet që ka arritur FSK-ja, duke premtuar se ndihma e Gardës Kombëtare të Ajovës nuk do të mungojë asnjëherë për FSK dhe Kosovën.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama priti komandantin e Gardës kombëtare të Ajovës, gjeneral major Timothy Orr

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, prit sot, në takim komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës (GKA), gjeneralin Timothy Orr. Gjeneral Rama, gjatë takimit të përbashkët, falënderoi gjeneralin Orr për ndihmën e vazhdueshme që SHBA-të dhe Garda Kombëtare e Ajovës po japin për FSK-në në kuadër të programit "Partneritetit për Paqe". Gjatë takimi, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e njoftoi gjeneralin Orr për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK), si dhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, shkollimet, trajnimet dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.


Gjithashtu, të dy gjeneralët biseduan edhe për bashkëpunimin e deritashëm në mes FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, me theks të veçantë për vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen, si dhe bartjen e përvojave profe-



sionale të Gardës Kombëtare të Ajovës, për FSK-në. Ndërsa, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Timothy Orr, shprehu gatishmërinë e Gardës Nacionale të Ajovës për të ndihmuar FSK-në në mënyrë të pakursyer edhe në të ardhmen.

Delegacion i MFSK-së në Sarajevë, pjesë e takimeve "SHBA-Karta e Adriatikut A-5"

Një delegacion i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, kryesuar nga z. Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane në MFSK dhe kolonel Fadil Hadergjonaj për herë të parë u ftuan zyrtarisht në Sarajevë nga Ministria e Mbrojtjes së Bosnjës dhe Hercegovinës në cilësinë e nikoqirit të takimit të drejtorëve për Politika dhe Plane të ministrive të Mbrojtjes të vendeve në kuadër të "SHBA-Karta e Adriatikut A-5" të mbajtur në Sarajevë.



Në këto takime u diskutuan çështje të projekteve në kuadër të iniciativave rajonale, si: A-5, SEDM, (Ministritë e Mbrojtjes të Shteteve të Evropës Juglindore) B-9, marrëveshjet e bashkëpunimit bilateral në kuadër të menaxhimit të emergjencave dhe çështje që ndërlidhen me pjesëmarrjen në operacione ndërkombëtare në Afganistan, mbështetje të operacioneve të udhëhequra nga NATO, Bashkimi Evropian (BE) dhe Kombet e Bashkuara (KB).

Gjatë takimit janë diskutuar edhe ide që kërkojnë fuzionimin e iniciativave rajonale dhe aktiviteteve tjera në mënyrë që mos të dyfishohen aktivitet dhe po ashtu të përdoren të gjitha aftësitë ushtarake në mënyrë sa më efektive. Kjo është hera e parë, që zyrtarisht një delegacion i MFSK-së, merë pjesë në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjenerallejtënant Rrahman Rama përcolli ushtrimin fushor "Shpëtimtari 2015" të RMC-së



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me drejtorin e Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT), gjeneral brigade Werner Haumann, atasheun ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në Prishtinë, kolonelin Chad Butts, shefin e Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonelin Naim Haziri, përcolli nga afër zhvillimin e ushtrimit fushor "Shpëtimtari 2015" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të Brigadës së Mbështetjes Operacionale, në fshatrat Batllavë dhe Orllan të Komunës së Podujevës. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama u pritë nga komandanti RMC-së, koloneli Shaip Haziri i cili e njoftoi komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën, me rrjedhën e ushtrimit dhe njëherë falënderoj ekipin amerikan për ndihmën që kanë dhënë dhe po japin në kontrollin dhe vlerësimin e ushtrimit, si dhe në fusha të tjera. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, e vlerësoi shumë të rëndësishëm mbajtjen e këtij ushtrimi fushor dhe të ushtrimeve të tjera, në nivel të njësive dhe atë të përgjithshme për FSK-në, "sepse qëllimi im është mbajtja e kapaciteteve ekzistuese dhe se këto kapacitete do të mbështeten dhe zhvillohen në vazhdimësi dhe si të tilla do të transferohen edhe në Forcat e Armatosura, pasi që këto njësi sa më të përgatitura i nevojiten vendit në raste krizash". Ndërsa, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) koloneli Shaip Haziri tha se qëllimi i mbajtjes së ushtrimit fushor "Shpëtimtari 2015" ishte sfida garuese e njësive të RMC-së, Task Forcës, Deminimit, MKAB-së dhe që të finalizohet operacionaliteti i të gjitha njësive së bashku në terren.

Aleanca Kosovare e Biznesit mirënjohje për FSK-ë



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim kryetarin e Aleancës Kosovare të Biznesit, zotëri Agim Shahinin me bashkëpunëtorë. Zotëri Shahini në emër të Aleancës Kosovare të Biznesit i dha komandantit të FSK-së, gjeneral Ramës një mirënjohje me moton:,,Unë Konsumoj Prodhime Vendore, po Ju?, me motivacionin: ,,Për kontribut dhe konsum të prodhimeve vendore për ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës". Gjeneral Rama e falënderoi kryetarin Shahini për vizitën dhe interesimin e AKB-së për FSK-në, si dhe për mirënjohjen që kjo organizatë ndau për FSK-në. Gjenerali Rama gjithashtu shprehu konsideratë për angazhimin e biznesit vendor, si kontribuuese në ekonominë e Kosovës. Nga ana e tij, Agim Shahini, tha: ,,Qëllimi pse ne jemi sot këtu është që t' ju mbështesim në zhvillimin tuaj, dhe të shprehim konsideratën e AKB-së për Ju, si komandant i FSK-së, dhe për FSK-në si institucion besnik i konsumimit të prodhimeve vendore". Gjithashtu z. Shahini foli edhe për bashkëpunimin e shkëlqyer në disa projekte në mes AKB-së dhe FSK-së, dhe premtoi thëllimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Kjo ishte vizita e parë e kryetarit të AKB-së dhe disa prej prodhuesve vendorë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, që nga koha kur gjeneral Rama ka marrë detyrën e komandantit të FSK-së.



Marrëveshje bashkëpunimi në mes FSK-së dhe PTK-së

Në ambientet e Postës dhe Telekomit të Kosovës, sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës z. Shkëlzen Sylaj dhe drejtori menaxhues i Postës dhe Telekomit të Kosovës z. Agron Mustafa kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Me këtë rast, z. Sylaj, tha se, kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet FSK dhe Vala, do të thellojë bashkëpunimin edhe më shumë. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje është një hap i rëndësishëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës, që të ketë shërbime cilësore nga operatori më i madh Vala.
Ndërsa, z. Mustafa, tha se, nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim me FSK-në, bëhet më i veçantë duke pasur parasysh edhe faktin tjetër, që shumë shpejt pritet të bëhet transformimi dhe kalimi i FSK-së në Ushtri të Kosovës, pas një vendimi që pritet të marrë Kuvendi i Kosovës. Drejtori Mustafa premtoj efikasitet dhe cilësi në zbatimin e marrëveshjes ndërmjet FSK-së dhe PTK-së. Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim që të lehtësojë komunikimin për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, shërbyesit civil të ministrisë dhe stafit politik.
Marrëveshja ndërmjet FSK dhe PTK-së, u zyrtarizua me rastin e nënshkrimit të saj.

Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së Shkëlzen Sylaj priti deputetët e grupit parlamentar Gjashtë Plus

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Shkëlzen Sylaj priti në takim deputetët e grupit parlamentar Gjashtë Plus, zonjën Myfera Sheniki dhe Fikrim Damka, përfaqësues të minoritetit turk. Në takim u diskutua pozita e minoriteteve në FSK, me theks të veçantë pozita e minoritetit turk, si dhe mundësia e inkuadrimit të tyre në numër më të madh në FSK. Gjatë këtij takimi ata biseduan edhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, me ç'rast deputetët e Kuvendit të Kosovës nga radhët e grupit parlamentar Gjashtë Plus u njoftuan me planet dhe me përgatitjet e këtij procesi.

Komandanti i KDS-së gjeneral Enver Cikaqi mori pjesë në diplomimin e oficerëve të lartë në Kroaci

Me ftesë të komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Ushtrisë së Kroacisë, gjeneralit Bllazhe Beretin, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi i shoqëruar edhe nga kolonel Fadil Hadërgjonaj, shef i Shtabit të KDS-së dhe major Qazim Gllareva, shef i Sektorit të Operacioneve, qëndruan për një vizitë zyrtare treditore në Kroaci. Gjenerali Enver Cikaqi, gjatë qëndrimit në Kroaci, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të nënoficerëve dhe oficerëve në Akademinë Ushtarake Kroate, në Zagreb, e cila ishte përgatitur me protokollin më të lartë shtetëror, ku pjesëmarrës ishin edhe presidentja e Kroacisë, Kotlinda Kitaroviq, kryeministri i Kroacisë Zoran Milanoviq dhe delegacionet tjera të shtetit kroat, njëherësh konsiderohet ceremonia më e lartë shtetërore. Në këtë ceremoni diplomuan edhe 3 oficerë të FSK-së, të cilët kanë ndjekur trajnime të ndryshme njëvjeçare, si: Nënkolonel Hasan Hoxha, Shkolla e Luftës, major Reshat Parallangaj, Shkolla e Komandës dhe Stafit dhe toger Besim Dervoviq, Shkolla e Avancuar e Oficerëve. Oficerët e FSK-së, gjatë shkollimit në Kroaci, treguan rezultate shumë të mira, u tha gjatë ceremonisë. Gjeneral Cikaqi, gjatë qëndrimit në Kroaci vizitoi edhe disa kazerma dhe shkolla ushtarake, ku nga stafi i tyre u njoftua me programet dhe pajisjet trajnuese të cilat i ka në shfrytëzim ushtria kroate. Më 24 qershor 2015, delegacioni i FSK-së, në shoqërim të gjeneralit kroat, Bllazhe Beretin zyrtar Qendrën e Stërvitjes Bazike në Pozhegë të Kroacisë, ku u njoftuan nga afër me procedurat, programin, rolin dhe rëndësinë që ka kjo qendër trajnuese. Delegacioni i FSK-së, gjithashtu vizitoi edhe Poligonin e stërvitjes dhe qitjeve në Gashinc, që është njëri nga poligonet më të mëdha të ushtrisë kroate, poligon i cili përfshin të gjitha llojet e stërvitjes për këmbësori. Nga stafi i poligonit u bë prezantimi dhe njoftimi me detyrat dhe funksionin e këtij poligoni gjithëpërfshirës për këmbësori. Ndërsa, më 26 qershor 2015, komandanti i KDS-së, vizitoi Qendrën Simulative të Ushtrisë Kroate në Zagreb dhe Qendrën Ndërkombëtare për Stërvitje Operative në Rakitje, ku u njoftuan me rolin dhe programet trajnuese të cilat zhvillohen në këto qendra. Në fund të vizitës, të dy gjeneralët: Bllazhe Beretin dhe Enver Cikaqi, u pajtuan dhe shprehën gatishmërinë për bashkëpunim edhe në të ardhmen, në shumë fusha me interes të përbashkët.



U diplomuan kadetët e rinj të FSK-së, gjenerata 2015





Në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, më 29 qershor 2015, u zhvillua ceremonia solemne e diplomimit të kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare (QSU) të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerata 2015. Në ceremoni morën pjesë: ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme Skënder Hyseni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral major Thimoty Orr, zëvendës ministri i MFSK-së, z. Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Bashkim Jashari, Zymer Halimi, Enver Cikaqi, ushtarakë të lartë të Ministrisë dhe të FSK-së, atashetë ushtarakë të akredituar në Prishtinë, kryetarë komunash, familjarë të kadetëve, si dhe të ftuar të tjerë. Të pranishmit i përshëndeti ministri i Ministrisë së FSK-së, z. Haki Demolli, i cili e vlerësoi këtë ceremoni si një ditë të veçantë në jetën dhe karrierën e të diplomuarve, por edhe si një ngjarje të shënuar për FSK-së, "diplomimi dhe gradimi i 11 kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, në gradën e nëntogerit, është një ditë tejet e rëndësishme dhe e shumëpritur, jo vetëm për kadetët e diplomuar, familjet e tyre, por edhe për Ministrinë dhe FSK-në në përgjithësi. Është ditë në të cilën po bëhet kurorëzimi i një pune të gjatë dhe tani pas 4 viteve angazhimi, sakrifice, këmbëngulësie, po e realizoni ëndrrën tuaj, duke u bërë solemnisht oficerë të karrierës në uniformën e FSK-së, që është uniformë e shenjtë dhe shumë e çmuar për popullatën e Republikës së Kosovës".

Ministri Demolli, duke ju drejtuar kadetëve, tha: "Me sukses ia dolët duke i tejkaluar të gjitha sfidat që u paraqitën para jush dhe sot, në këtë ditë, ju po kaloni në një fazë të re të jetës tuaj, sepse po përmbushni të gjitha kushtet dhe po aktivizoheni si oficerë aktiv në FSK dhe kësisoj po filloni karrierën tuaj të oficerit". Ministri Demolli për suksesin e kadetëve përgëzoi edhe stafin e KDS-së si dhe stafin trajnues të Qendrës së Studimeve Universitare (QSU), për punën e tyre të palodhshme në përgatitjen dhe stërvitjen e gjeneratës 2015, e cila siç thotë ai: "Jam plotësisht i sigurt se do të jetë e gatshme t'i përmbush me sukses të gjitha obligimet dhe sfidat profesionale me të cilat do të ballafaqohet në karrierën prej oficeri. Investimet e kësaj natyre, janë garanci më e mirë se Ministria jonë po e krijon një forcë profesionale sipas standardeve më të larta, pra sipas standardeve të NATO-s". Ministri Demolli, më pastaj i porositi kadetët e sapo diplomuar: "Oficerë të rinj, mos harroni se, nuk ka mision më të shenjtë se sa të jesh oficer në shërbim të mbrojtjes së lirisë dhe demokracisë; vlera dhe parime këto për të cilat gjenerata të tëra kanë sakrifikuar shumë, madje edhe duke flijuar jetën e tyre". Ndërsa, për shkollimin e kadetëve në Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së, ministri Demolli tha: "Doktrina e stërvitjes dhe shkollimi i kadetëve tanë, bazohet në tërësi mbi njohuritë dhe shkencën ushtarake, të ngjashme me ato të ushtrive tjera bashkëkohore, duke zhvilluar njëkohësisht studime paralele edhe në institucione civile, konkretisht në Universitetin Amerikan të Kosovës". Në fund, ministri Demolli para kadetëve ritheksoi se: "diplomimi i juaj është më ndryshe, se sa i gjeneratave të tjera, sepse ju diplomuat në vitin, kur Kosova, Ministria dhe FSK-ja, kemi bërë të gjitha përgatitjet për transformimin e FSK-së, në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK), e cila do të ketë një strukturë të re, mision të ri dhe mundësi të reja për ju si oficerë të rinj, që me punën tuaj nëpër njësite të ndryshme, të mund të jepni kontributin tuaj, në ngritjen dhe profesionalizimin e Forcave të Armatosur të Kosovës". Ai, premtoi bashkëpunim dhe përkrahjen pa rezervë të stafit të Ministrisë dhe FSK-së, për kadetët e sapo diplomuar.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij, drejtuar kadetëve, tha: "Ju po bëheni pjesë e FSK-së, në një kohë shumë të rëndësishme për vendin tonë. E di që rruga për të ardhur deri këtu nuk ishte e lehtë, por, ju duhet të ndiheni krenar për të arriturat e juaja. Ju po bëheni pjesë e institucionit i cili po i shërben vendit dhe të gjithë qytetarëve pa dallim. Ju keni përzgjedhur një profesion fisnik, ju keni zgjedhur që t'i shërbeni vendit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ky virtyt i vetëmohimit dhe shërbimit me nder dhe integritet na duhet më tepër se kurrë. Ky është vetëm fillimi i rrugëtimit tuaj në këtë profesion fisnik. Gjatë karrierës tuaj ju do të ballafaqoheni me sfida të ndryshme. Por gjithmonë mbani në mend betimin që so to të jepni. Ne jemi në shërbim të vendit atëherë kur vendi ka nevojë më së shumti për ne. Unë nga ju pres që të jeni oficerë të devotshëm, këmbëngulës dhe të përkushtuar në kryerjen e detyrave që ju jepen, të udhëhiqni dhe motivoni vartësit, të jeni shembull për vartësit tuaj, si dhe gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ne kemi hyrë në një fazë të rëndësishme të përgatitjes së transformimit nga FSK në FAK. Kjo periudhë kërkon angazhim shtesë nga gjithë ne. Ju me aftësitë dhe dijet e fituara, gjatë procesit të vështirë dhe sfidues të këtij shkollimi, si dhe gatishmërinë për të shërbyer me nder dhe dinjitet, do të jeni shembull i mirë i vazhdimësisë së ngritjes së FSK-së dhe forcës së ardhshme, ashtu siç janë gjeneratat tjera para jush". Gjeneral Rama, në fund përgëzoi stafin e KDS-së, të Qendrës për Studime Universitare, të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm kanë punuar në edukimin dhe trajnimin e oficerëve të rinj, si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë të cilët vazhdimisht na përkrahin në proceset e rëndësishëm të edukimit, shkollimit dhe stërvitjes si dhe ngritjes së kapaciteteve tona.

Pas leximit të urdhrit për gradimin e 11 kadetëve në gradën e nëntogerit, ministri Demolli, gjeneral Rama, gjeneral Orr, gjeneral Cikaqi dhe kapiteni Kiqina iu dhanë certifikata, oficerëve të rinj të FSK-së. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama i dorëzoi kadetit më të mirë, të gjeneratës 2015, nëntoger Shpend Hajdinit, çmimin "Kadeti më i mirë i gjeneratës 2015". Kadetët e sapo diplomuar dhanë betimin solemn para komandantit të QSU-së, kapiten Avni Kiqina.

Kadetët e FSK-së kanë kryer studimet në Qendrën për Studime Universitare dhe në Universitetin Amerikan të Kosovës. Kadetët e diplomuar janë: Arsim Dreshaj, Arlind Bajrami, Armend Jashari, Driant Hoti, Florent Sadiku, Leutrim Hoti, Xhevahir Hasanaj, Shpend Hajdini, Shpëtim Ujkani, Genti Koqinaj dhe Ismail Sekiraqa. Ata sot u graduan dhe u janë caktuar detyrat të cilat do t'i kryejnë në njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Gjenerali Orr i uroi kadetët e pasadiplomuar në gjuhën shqipe

"Ministër Demolli, gjeneral Rama, gjeneralë, oficerë, nënoficerë, prindër, familjarë dhe miq Të nderuar familjarë, është një nderë dhe privilegj që të jem prezent sot në diplomimin e kadetëve. Urime,

Sot është fillimi i një jete të re në karrierën tuaj ushtarake, Ju keni punuar shumë gjatë katër viteve të fundit për ta fituar këtë gradë, Kosova është krenare me ju sot, Ju jeni më të mirët. Sot, Kosova, Shtetet e Bashkuara dhe Ajova janë shumë krenarë me ju. Sot bëhet fjalë për potencialin tuaj të ardhshëm, e jo për atë qe keni bërë gjatë katër viteve të fundit. Ju nuk keni ardhur këtu të vetëm, kushtojuni pak kohë familjeve për t'i falënderuar për sakrificën dhe mbështetjen. Ju keni marrë besimin e prindërve kosovarë për jetën e fëmijëve të tyre dhe pritet nga ju që të bëni gjërat e duhura. Kosova ka investuar shumë për të ju sjellë deri këtu. Secili nga ju do të shkojë në trajnime dhe shkollime nëpër botë. Kjo është mundësia e juaja për të mësuar apo për të bërë gabime. Unë ju uroj më të mirat në jetë gjenerata e pesëmbëdhjetë".







FSK-ja nderon Heroin Kombëtar Isa Boletini



Në kuadër të organizimit të ceremonisë së rivarrimit të Heroit Kombëtar Isa Boletini, më 10 qershor 2015 në Boletin të Mitrovicës, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), janë angazhuar me detyra të shumta. Këshilli organizativ është themeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kurse i tërë manifestimi është mbajtur nën përkujdesjen e kryeministrit të Qeverisë së Kosovës zotit Isa Mustafa. Kryetar i Këshillit organizativ ishte z. Haki Demolli, ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Aktivitet për ceremoninë e rivarrimit të Heroit Kombëtar Isa Buletini, zyrtarisht kanë filluar më 5 qershor 2015, me punimet e konferencës shkencore, ?Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare?, të organizuar nga Instituti i Historisë nga Prishtina, Instituti i Historisë nga Tirana dhe Instituti për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve nga Shkupi. Në këtë Konferencë ministri Haki Demolli lexoi fjalën përshëndetëse për të pranishmit, ku foli për figurën e Heroit Kombëtar Isa Boletini, për rëndësinë e manifestimit të rivarrimit, të organizuar nga qeveria e Republikë së Kosovës dhe angazhimin e FSK-së në aktivitet e nevojshme. Aktiviteti dhe tërë organizimi ka qenë i udhëhequr nën moton domethënëse ?Prapë, na erdhi Baca Isë?. Aktivitet e FSK-së kanë qenë në lartësinë e angazhimeve të agjendës së manifestimit. Në të gjitha aktivitet duke filluar nga data 8 qershor 2015, FSK-ja ka qenë e angazhuar me staf drejtues, me Njësinë Ceremoniale, Policinë e Forcës, me transport, me logjistikë dhe me mjete teknike të nevojshme. Me aktivitete të ndryshme të parapara në skenar, protokoll dhe agjendë të manifestimit, kanë qenë të angazhuar njësitë e FSK-së: më 8 qershor në Prizren, Deçan, Isniq; më 9 qershor në Skenderaj, Prishtinë, Kuvendin e Kosovës dhe Mitrovicë dhe më 10 qershor në manifestimin qendrorë në stadiumin e qytetit ?Adem Jashari? në Mitrovicë. I gjithë manifestimi, sipas Këshillit Organizativ, është zhvilluar sipas agjendës së planifikuar dhe në mënyrë dinjitoze.





Kadetët e Qendrës së Studimeve Universitare me sukses realizuan "Kampin Veror 2015"



Kadetët e Qendrës së Studimeve Universitare (QSU) të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për 15 ditë, nga data: 5-20 qershor 2015, qëndruan jashtë kazermës, në terren, në "Kampin Veror 2015" në fshatin Zhegoc, Komuna e Gjilanit. Ky kamp u realizua në bazë të planit vjetor të Qendrës së Studimeve Universitare për kamping dhe realizimin e të gjitha ushtrimeve të përbashkëta me të gjithë kadetët e QSU-së. Qëllimi i mbajtjes së këtij kampi ishte vlerësimi i aftësive taktike të kadetëve të QSU-së, në planifikim, në përgatitje dhe në ekzekutim të operacioneve luftarake, ku gjatë kësaj kohe, kadetët patën mundësinë të praktikojnë në terren operacione luftarake të mësuara gjatë këtij viti. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 19 qershor, vizitoi "Kampin Veror 2015", ku u prit nga komandanti i Qendrës së Studimeve Universitare (QSU), kapiten Avni Kiçina i cili e njoftoi më hollësisht komandantin e FSK-së, rreth formimit të kampit dhe stërvitjeve të mbajtur në kamp, si dhe për specifikat e veçanta të realizimit të stërvitjeve gjatë mbajtjes së kampit.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, përgëzoi instruktorët dhe kadetët e QSU-së për angazhimin maksimal gjatë stërvitjeve, ku realizimi i tyre është mjaft i rëndësishëm për të ardhmen e FSK-së. "Këto trajnime janë të rëndësishme për ne dhe të mirëseardhura që ta ngremë më shumë nivelin profesional". Komandanti i FSK-së kërkoi nga të gjithë kadetët angazhim maksimal në kryerjen e detyrave me sukses, ashtu siç janë paraparë në planin vjetor të QSU-së. Më pas, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me zëvendës komandantin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) kolonel Irfete Spahiu dhe atasheun ushtarak të SHBA-ve në Prishtinë, koloneli Chad Butts, përcollën një demonstrim në terren të kadetëve të FSK-së.

"Kampi Veror 2015" ka filluar më 5 qershor dhe ka përfunduar më 20 qershor 2015, ku gjatë këtyre ditëve u bë finalizimi i trajnimeve të ndryshme fushore, sipas planit vjetor të QSU-së.

Nënshkruhet plani për bashkëpunim në mes Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë dhe Ministrisë së FSK-së

Zëvendësministri i Mbrojtjes i Republikës së Maqedonisë, zoti Ilmi Selami, takoi sot, delegacionin nga Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës, i cili po qëndron për një vizitë pune në Maqedoni, kryesuar nga kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Bashkëpunim në Ministrinë e FSK-së. Gjatë takimit, zëvendësministri Selami, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe deklaroi, se "Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë do të jetë vazhdimisht e gatshme të ndajë përvojat e saja nga sferat e Mbrojtjes me Forcat e Sigurisë së Kosovës si dhe do të ofrojë kapacitetet ushtarake për një bashkëpunim më të mirë në sferën e mbrojtjes. Vazhdimi i shkëmbimit të përvojave ndikon në masë të madhe në avancimin e çështjeve me rëndësi për sigurinë e dy vendeve dhe rajonit"- theksoi në fund, z. Selami.

Ndërsa, koloneli Qeriqi shprehu mirënjohje në emër të tij dhe të FSK-së, për mbështetjen që ofron Ministria e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë në shkollimin e kadetëve të FSK-së në Akademinë e Mbrojtjes dhe trajnimeve në Qendrën Rajonale për Marrëdhënie me Publikun dhe në Qendrën për Mjekësi Ushtarake. Gjithashtu kolonel Qeriqi përshëndeti gatishmërinë e zëvendësministrit Selami për një vizitë të ardhshme në Ministrinë e FSK-së. Qëllimi i vizitës së delegacionit të FSK-së në Ministrinë e Mbrojtjes të Maqedonisë, ishte nënshkrimi i



Planit për Bashkëpunim Bilateral për vitin 2015, që u realizua në ditën e djeshme midis sektorëve përkatës, si dhe u realizuan vizita pune në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë.



Ushtarakët dhe personeli civil i MFSK-së dhe FSK-së përkrahen instalacionin artistik „Mendoj për Ty”

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, dorëzuan një donacion të grumbulluar vullnetarisht nga ushtarakët dhe shërbyesit civilë në mbështetje të instalacionit artistik „Mendoj për Ty", të artistes Alketa Xhafa-Mripa, të organizuar nga Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, i themeluar dhe i udhëhequr nga Presidentja e Republikës së Kosovës zonja Atifete Jahjaga. Aksioni është realizuar nga zonja Luljete Rexhepi -Vitija dhe është mbështetur nga ministri Haki Demolli dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, si dhe është përkrahur nga dhurues të shumtë në MFSK dhe FSK. Në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, donacionin me fustanet e grumbulluara e dorëzuan në pikën e grumbullimit: „Dit e Nat" në Prishtinë, majoret Remzie Zeqiraj dhe Leonora Gjinovci si dhe zonjat Luljete Rexhepi-Vitija dhe Kimete Beqiri. Aksioni në mbështetje të iniciativës: „Mendoj për Ty", në MFSK dhe FSK u zhvillua më 2 dhe 3 qershor 2015.

Në FSK përfundoi "Kampi Rinor 2015" i nxënësve të shkollave të mesme

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve në 'Kampin Rinor 2015' që ka filluar më 01-05. 06. 2015, ku morën pjesë 46 nxënës të shkollave të mesme nga komunat e Republikës së Kosovës.

Pjesëmarrësit e këtij kampi i përshëndeti komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. "Unë falënderoj nxënësit dhe instruktorët e FSK-së për kontributin e tyre që kanë dhënë në mbarëvajtjen e kampingut rinor, njëherësh nxënësve ju uroj shumë suksese në shkollë dhe në jetë. Besoj se ju tani e keni kuptuar mirë jetën reale të FSK-së, si dhe jeni njoftuar me misionin, strukturën dhe aktivitete e përgjithshme të FSK-së, e cila gjithmonë duhet të jetë e përgatitur për t'iu dalë në ndihmë të gjithë atyre që e kërkojnë këtë nga ne. Është me rëndësi për ju, që këto njohuri të mësuara këtu t'i ndani bashkë me moshatarët tuaj, miqtë dhe familjet tuaja. Besojmë se në të ardhmen edhe shumë nga ju do të jeni pjesë e FSK-së. Ne si Forcë e Sigurisë së Kosovës jemi gjithmonë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës, tha në fund komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Ndërsa, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi përgëzoi nxënësit për angazhimin e tyre për të marr njohuri të reja nga jeta ushtarake. Ai tha: "Prania juaj e ka begatua këtë aktivitet dhe punën tonë në përgjithësi. Kjo ka qenë një përvojë e përbashkët si nga ana juaj po ashtu edhe nga ana jonë, se tashmë i kemi parë edhe aftësitë e juaja dhe përkushtimin tuaj ndaj librit, ndaj mësimeve, si dhe interesimin që keni pas edhe për familjen gjatë qëndrimit tuaj këtu". Përveç temave teorike dhe operacionale, këtu janë ligjëruar edhe tema me karakter historik e sidomos historiku dhe ndërlidhja e UÇK-TMK-FSK, të cilat janë ligjëruar nga drejtori i Departamentit të BCU-së, z. Hajrush Kurtaj.

Nxënësit pjesëmarrës në Kampin Rinor 2015, u shprehen shumë të emocionuar për qëndrimin e tyre njëjavor në KDS, ku shumica prej tyre shfaqën dëshirën që të bëhen pjesë e FSK-së në të ardhmen, pasi që jeta ushtarake ju pëlqen shumë. Të jesh pjesë e këtij kampi është më të vërtet sfidë e veçantë. Këtu kemi zhvilluar shumë aktivitete. Jemi ndier të kënaqur nga pritja dhe puna e palodhshme e instruktorëve të FSK-së. Të gjithë u shprehën se ndjehen krenarë me uniformën e FSK-së, të cilën e bartën gjatë kësaj jave.



Kampi Rinor 2015, është organizuar nga Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe drejtorit komunale të arsimit. Drejtori i BCU-së, z. Hajrush Kurtaj tha se ky është viti i dytë i organizimit të kampit veror. Qëllimi i kampit ka qenë që të rinjtë tanë ta kolonjë një javë në ambientet e kazermës "Skënderbeu" këtu në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Në ceremoni morën pjesë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, atasheu ushtarak i SHBA-ve, koloneli Chad Butts, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, z. Hajrush Kurtaj, këshilltari i komandantit të FSK-së, nënkolonel David Jones si dhe instruktorë, oficerë dhe nënoficerë të Ministrisë dhe FSK-së.

Certifikohen 20 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë nga instruktorë të SHBA-ve



Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt ceremonia e certifikimit të 20 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në fushën e inteligjencës, të cilët për një javë ndoqën trajnimin "Roli i G2/S2 në nivel Brigade dhe Batalioni " nga ekipi i instruktorëve të USAEUR-it (Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Evropë).

Në ceremoninë e diplomimit mori pjesë edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama. Ai i falënderoi të gjithë pjesëtarët dhe instruktorët për përkushtimin dhe kontributin e dhënë gjatë këtij trajnimi; "Dua të falënderoj instruktorët e ushtrisë amerikane, për përkushtimin dhe kontributin e dhënë në ngritje të FSK-së, ndërsa nga pjesëtarët e FSK-së kërkoj që njohuritë e fituara t'i shpërndajnë tek vartësit dhe njësitë e tyre, pasi që së shpejti na pret një mision i ri, dhe këto përvoja do të na nevojiten në ngritjen dhe profesionalizimin e mëtejmë të njësive të FSK-së". Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ndau mirënjohje për instruktorët amerikanë, të cilët kontribuuan në mbajtjen e këtij trajnimi me rëndësi të veçantë për FSK-në.

U mbajt Konferenca; Perspektiva e Ndërtimit të Integritetit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Vijon nga faqja 1

Duke folur për ngritjen dhe sforcimin e integritetit të të punësuarve në MFSK, Ministri Demolli shtoi se:" një ndër qëllimet dhe prioritet themelor, të cilat synojë t'i realizojë gjatë mandatit tim, si ministër i MFSK-së, është ngritja dhe sforcimi i integritetit të të punësuarve në MFSK. Integriteti është një normë e cila nuk duhet nënkuptuar vetëm nga aspekti i ngushtë, pra ai praktik i etikës, por para së gjithash duhet nënkuptuar edhe nga aspekti i ndërtimit dhe zhvillimit të mekanizmave që mundësojnë parandalimin e korrupsionit dhe keqpërdorimeve të tjera në detyrë. Në këtë rrafsh, MFSK-ja do të përfshihet në planin veprues të Strategjisë Kundër Korrupsionit. Si rrjedhojë, pritet që MFSK-ja do të ketë obligime shtesë për zbatimin dhe përkushtimin e të gjitha kërkesave në funksion të ngritje së integritetit. Ngritjen e integritetit në MFSK nuk duhet parë vetëm si një detyrë që duhet përmbushur, por edhe si një normë dhe vlerë që duhet integruar dhe forcuar në të gjitha nivelet e MFSK/FSK-së".
Ministri Demolli, më tej, u ndal edhe tek praktikat e shteteve demokratike, për të shtuar se: "duke pasur parasysh praktikat e shteteve më demokratike në të cilat sektori i mbrojtjes reflekton nivelet më të larta të integritetit krahasuar me sektorë tjerë, ne synojmë që Ministria jonë të jetë model dhe kampion i integritetit në raport me agjencitë dhe ministritë tjera". Në fund, Ai, tha se do të angazhohemi maksimalisht që të zbatohet parimi i meritës në rekrutimin dhe gradimin e personelit, sepse ky proces paraqet një ndër shtyllat themelore të integritetit në MFSK. Përkushtimi ynë është për aplikimin e të gjitha parimeve që burojnë nga programi i NATO-s. Ndërsa, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Jan Braathu, tha se këtë projekt e ka realizuar shteti i tij në shumë shtete që tanimë janë anëtare të NATO-s. Nuk është projekt eksperimental por i zbatuar paraprakisht, dhe si i tillë realizohet me shumë përkushtim, me ndihmën dhe praktikat e sjella nga Norvegjia. Ky projekt do t`i ndihmojë Forcës së Sigurisë së Kosovës që të përmbushë një nga kriteret e NATO-s".
Në Konferencë folën, edhe: Z. Domenic Braithwaite, drejtor i Ekipit Këshillues të NATO-s, në MFSK, i cili u paraqit me temën; Perspektiva e NATO-s për fuqizimin e integritetit në MFSK. Ndërsa, Z. Sven Eriksen, këshilltar i lartë në Qendrën për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë, shtjelloi temën: Vlerësimi i integritetit në sektorin e mbrojtjes në Evropën Juglindore, kurse, z. Florian Qehaja, udhëheqës i Ekipit të Projektit për Kosovë, paraqiti temën: Gjendja ekzistuese e integritetit në MFSK, etj. Konferenca i përmbylli punimet, me diskutime konkrete rreth perspektivës së ndërtimit të integritetit në Ministrinë e FSK-së. Në fund, Konferenca - Perspektiva e Ndërtimit të Integritetit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, u vlerësua si shumë e suksesshme nga organizatori dhe pjesëmarrësit.

Pjesëtarët e Regjimentit të Mbrojtjes Civile u trajnuan nga instruktorët e kontingjentit turk



Në kazermën e FSK-së, "Ushtarët e rinj" në Pomozotin, u mbajt ceremonia e certifikimit për 14 pjesëmarrësit në Kursin për Lider, që është mbajtur nga data 28. 04-25. 06. 2015 nga instruktorët e KFOR-it të kontingjenti turk. N ë ceremoninë e certifikimit morën pjesë edhe shefi i Shtabit të Forcave Tokësore (KFT) kolonel Naim Haziri, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale(BMO) kolonel Muharrem Rrahmani, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) kolonel Shaip Haziri, kolonel Gyltekin Yarai, si dhe oficerë e nënoficerë të FSK-së dhe të KFOR-it. Komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri, me këtë rast, falënderoi ekipin e instruktorëve nga Turqia, për trajnimin e mbajtur dhe mbështetjen e vazhdueshme që po japin për Regjimentin e Mbrojtjes Civile dhe kontributin e Turqisë që është duke dhënë në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së. Ndërsa, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, gjatë fjalës së tij të mbajtur me këtë rast, falënderoi ekipin e instruktorëve të kontingjentit turk, për mbështetjen e ofruar në vazhdimësi për FSK-në, dhe në veçanti për Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së. Ai, shtoi: "Me këtë sukses rritet jo vetëm niveli i njohurive tuaja personale, por kemi edhe një rritje të mëtutjeshme të shkallës së përgatitjes dhe profesionalizmit tuaj, në lëmin e udhëheqjes ushtarake". Në fund u dhanë certifikata për pjesëtarët e FSK-së si dhe mirënjohje për instruktorë të kontingjentit turk.

Instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës zhvilluan trajnim për komunikim për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës



Në Kompaninë e Komunikimit në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, u mbajt ceremonia e certifikimit të 14 pjesëtarëve të cilët përfunduan trajnimin " Bashkëpunimi në fushën e komunikimit". Gjeneral Rrahman Rama në fjalën e tij, pasi përshëndeti ekipin e instruktorëve nga Garda Kombëtare e Ajovës, si dhe pjesëtarët e FSK-së, tha: "Komunikimi është truri i ushtrisë, pa një komunikim të mirë nuk mund të kemi operacione të suksesshme. Edhe në të kaluarën kemi pasur sfida, mirëpo besoj se me investimet që kemi bërë me ratifikimin e marrëveshjes kemi arrit që t'i kemi pajisjet të cilat janë ndërvepruese me ato të Ushtrisë Amerikane, në ketë rast të Gardën Kombëtare të Ajovës, që ka qenë edhe qëllim i yni. Në fund gjeneral Rama, deklaroi: "Në lëmin e komunikimit FSK-ja ka investuar shumë dhe se për perfeksionimin e komunikimit kemi pasur nevojë. Njëkohësisht kemi vlerësuar se në procesin ku jemi si organizatë, ne kemi nevoderi tek pjesëtarët tanë". Ky trajnim u realizua nga ekipi i instruktorëve të Gardës Kombëtare të Ajovës, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prej; 15-19.06.2015, gjatë së cilit pjesëtarët u trajnuan për zhvillimin e planit të komunikimit dhe ndërveprueshmërinë në mes radiove Falcon II dhe Falcon III.
Në këtë ceremoni, përveç komandantit të FSK-së, ishin të pranishëm edhe atasheu ushtarak i SHBA-ve, në Prishtinë, koloneli Chad Butts, shefi i Zyrës së ODC-së në Kosovë, kolonel Bruce A. Murphy, drejtori i Departamentit të Komunikimit në MFSK, z. Beqir Bytyqi etj.
Gjeneral Rama në shenjë falënderimi u dha mirënjohje për ekipin e instruktorëve amerikanë.
Qëllimi i këtij trajnimi ishte që të ngritët niveli i njohurive për gjithë pjesëtarët e Kompanisë së Komunikimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Jeff Miser: Pjesëtarët e FSK-së janë shumë të përgatitur profesionalisht



Instruktori amerikan Jeff Miser,pas trajnimit, tha: "Ushtrisë së Kosovës i kemi ofruar një ushtrim akademik për Komandën e Misionit për Doktrinën amerikane, ambientin operacional, si dhe disa pika tjera nga programi ynë; metodologjinë e ndërtimit të ushtrisë e tjera, për disa pika apo mësime, se si operohet me procedura dhe koncepte të reja në një ambient operacional. Trajnimi ka zgjatur dy javë. Ditët e punës dhe niveli i trajnimit ku jemi angazhuar ne ka qenë shumë i lartë, duke ofruar njohuri dhe pikëpamje të sakta rreth doktrinës dhe konceptit doktrinar. Kadetët pjesëmarrës të këtij trajnimi kanë pasur njohuri paraprake për temat e zhvilluara, sepse ky lloj trajnimi kërkon përsëritje dhe besoj se është i mundur të zhvillohet edhe në të ardhmen, varësisht nga kërkesat tuaja. Mendoj se disa nga pjesëtarët e FSK-së kanë qenë shumë të përgatitur, dhe besoj plotësisht në aftësitë e tyre profesionale se këto mësime mund t'i përcjellin pa kurrfarë problemi tek vartësit e tyre.

34 oficerë të FSK-së ndoqën "Programin e Misionit të Komandës"




Në ambientet e Batalionit të Xhenios të Brigadës së Mbështetjes Operacionale të FSK-së, përfundoi trajnimi dy javor "Programi i Misionit të Komandës". Trajnimi u realizua nga ekipi i instruktorëve të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Evropë (USAEUR), në të cilin morën pjesë 34 oficerë nga të gjitha njësitet e të FSK-së.
Qëllimi i këtij trajnimit ishte arritja e nivelit profesional në "Programin e Misionit të Komandës", në përputhje me standardët e kërkuara. Në ceremoninë e certifikimit mori pjesë edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama si dhe përfaqësues të ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë.
Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama fillimisht falënderoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ambasadën e Amerikës në Prishtinë, si dhe instruktorët amerikanë, për ndihmën që ata po japin në ngritjen profesionale të FSK-së. Gjeneral Rama, me këtë rast, shtoi se; "Ky trajnim është shumë i rëndësishëm për ne, sepse filozofia e misionit të ri na detyron që të përgatitemi sa më mirë për detyra të reja, si dhe të përfitojmë sa më shumë nga përvoja e instruktorëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës". Ai, nga oficerët e FSK-së, kërkoi që njohuritë e fituara nga instruktorët amerikanë t'i bartën me sukses në njësitet e tyre, duke i përshtatur me realitetin tonë. Ndërsa instruktorët amerikanë; Jeff Miser dhe Bryan Kroontje, vlerësuan lartë angazhimin e oficerëve të FSK-së për përvetësimin e njohurive të reja nga ky program. Në fund komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama nderoi me mirënjohje të dy instruktorët amerikanë, me motivacionin për angazhim gjatë trajnimit "Programi i Misionit të Komandës".

Kadetë amerikanë dhe të FSK-së certifikohen në Programin e shkëmbimit kulturor dhe gjuhësor



Sot, në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve amerikanë dhe të FSK-së, të cilët për 3 javë, morën pjesë në Programin e njohjes së kulturës dhe për mësimin e gjuhës. Ky program u realizua falë bashkëpunimit dypalësh në mes Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ushtrisë së SHBA-ve. Në kuadër të këtij programi, morën pjesë gjithsej 28 kadetë amerikanë dhe 51 pjesëtarë-kadetë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në kuadër të realizimit të këtij programi, janë bërë vizita të shumta në qytetet e Kosovës duke filluar nga kazermat e FSK-së, vizita monumenteve të ndryshme historike, si dhe janë realizuar disa projekte si projekti për riparimin e shkollave dhe ai për pastrimin e qyteteve. Në ceremoninë e përfundimit të programit për shkëmbim kulturor, ishin të pranishëm: shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, atasheu i Mbrojtjes të SHBA-ve, në Prishtinë, kolonel Chad Butts, përfaqësues të KFOR-it amerikanë nga Bondstill, përfaqësues të ambasadës amerikane, oficerë të FSK-së, shefi i Ekipit Ndërlidhës të NATO-s, për KDS-në, nënkolonel Zoran Liposhçak, etj.



Zëvendëskomandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, kolonel Irfete Spahiu, me këtë rast, u shpreh:" Ky program është një mbështetje shtesë në kuadër të mbështetjes së vazhdueshme që SHBA-të janë duke i ofruar FSK-së, përmes trajnimeve për përmirësimin e nivelit të komunikimit në gjuhën angleze, duke mundësuar kështu komunikimin në mes kadetëve amerikanë dhe pjesëtarëve të FSK-së, për njohjen e kulturave tona të ndryshme, njohjen e vlerave historike dhe shkëmbimin e përvojave dhe të kuptuarit e programeve të trajnimit të njërës dhe palës tjetër." Tërë kjo është bërë në saje të bashkëpunimit në mes të FSK-së dhe ambasadës së SHBA-ve, në Prishtinë, por edhe mbështetjes së institucioneve lokale dhe qendrore të Kosovës, për çka ju jemi falënderues.

Ndërsa, atasheu i Mbrojtjes së SHBA-ve në Prishtinë, kolonel Chad Butts, në fjalën e tij, tha:" Më gëzon fakti që sot jemi bashkëpunuar këtu dhe po e përfundojmë këtë program në mënyrën më të mirë dhe me rezultate të larta. Kjo është një përvojë për të dyja palët, shkëmbim kulturash, traditash, gjuhësh etj. Janë këto elemente të cilat kërkojnë përkushtim dhe gatishmëri të cilën ju e keni treguar gjatë tërë kohës. Ne shpresojmë që ky program do të vazhdojë edhe në të ardhmen, nga ku do të kemi rast që të mësojnë të dy palët, kjo është një përvojë e mirë për kadetët tanë, e besoj edhe për pjesëtarët e FSK-së".

Në përfundim të ceremonisë së certifikimit, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, atasheu i SHBA-ve, kolonel Chat Butts dhe zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, kadetëve amerikanë dhe të FSK-së, u dhanë certifikata dhe mirënjohje, për rezultate të dalluara gjatë realizimit të Programit për shkëmbimin kulturor dhe për mësimin e gjuhës angleze.

Qeveria e SHBA-ve i dhuron FSK-së aparatura për paramedikë





Në kazermën "Lidhja e Prizrenit" në Prizren, sot u mbajt ceremonia e certifikimit të 20 pjesëtarëve të Kompanisë së Deminimit, të cilët që nga data 22-26.06.2015, kryen trajnimin "Reaguesi i parë në vend të ngjarjes (EOD)", i cili u realizua nga ekipi i instruktorëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, REUR . Po ashtu me këtë rast u bë edhe dorëzim-pranimin i një donacioni me aparatura për paramedikë, që kap vlerën e 50 mijë dollarëve amerikanë, dhuratë nga Qeveria e SHBA-ve. Komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), kolonel Shaip Haziri, pasi i përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit dhe në veçanti instruktorët amerikanë si dhe pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit, që përfunduan me sukses këtë trajnimin, ndër të tjera, shtoi: "po e përmbyllim një trajnim mjaft të rëndësishëm me instruktorë të Amerikës, të cilët janë duke bërë punë të madhe, për ne, në vazhdimësi, gjë që i ndihmon pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit, që edhe më tej, të jenë të përgatitur dhe të pagabueshëm, siç ishin, tash e 15 vjet". Ndërsa, atasheu ushtarak i SHBA-ve, në Prishtinë, koloneli Chud Butts u shpreh mjaft i kënaqur me suksesin e pjesëtarëve të Kompanisë së Deminimit." Është sukses mjaft i madh për pjesëtarët tuaj që nuk kanë pasur asnjë incident për këto vite pune. Trajnimet e tilla mundësojnë që Kompania e Deminimit të jetë në gjendje të përballojë edhe ndonjë problem në raste eventuale, dhe ky donacion me pajisje në vlerë prej 50 mijë dollarësh do jetë në dispozicionin tuaj dhe të këtyre 20 pjesëtarëve, që sot u aftësuan për përdorimin e këtyre pajisjeve".Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës të aftësohen në përdorimin e pajisjeve të reja, të cilat Qeveria e SHBA-ve i dha për trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së, të ndihmës së parë, " Reaguesi i parë në vend të ngjarjes (EOD)". Në këtë ceremoni, të pranishëm ishin: komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO), kolonel Muharrem Rrahmani, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), kolonel Shaip Haziri, shefi i Operativës së Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Bashkim Shillova, atasheu ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë, kolonel Chud Butts, shefi i Zyrës së ODC-së, kolonel Bruce A. Murphy si dhe oficerë të FSK-së dhe të SHBA-ve.

Certifikohen 30 kadetë të FSK-së në kursin për Lider Luftarak dhe Ndihmë të Parë

Në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, sot u mbajt ceremonia e certifikimit të 30 kadetëve të FSK-së, të cilët për katër javë, kryen kursin e Liderit Luftarak me sukses duke arritur rezultate të larta. Kursi i cili tashmë planifikohet, përgatitet dhe realizohet nga instruktorë të FSK-së, është marrë si model nga Ushtria e SHBA-ve dhe është përshtatur për nevoja të FSK-së.

Kadetët dhe pjesëmarrësit në ceremoni i përshëndeti zëvendëskomandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes kolonel Irfete Spahiu. Kolonel Spahiu pasi përgëzoj kadetët dhe instruktorët për organizimin dhe realizimin e këtij kursi, shtoi: "Instruktorët tanë kanë bërë një punë të zellshme për të realizuar këtë kurs, dhe KDS do të jetë krenare dhe falënderuese për ju dhe Akademinë e SHBA-ve dhe shtatë nënoficerë e ushtrisë së saj, për kontributin që kanë dhënë në përgatitjen e kuadrit tonë profesional, për të realizuar kurse si ky. Të nderuar kadetë, rezultatet e juaja po na bëjnë të mburremi dhe të ndihemi të motivuar edhe ne, por, edhe vërejtjet dhe sugjerimet e juaja na ndihmojnë që ta ngremë edhe më shumë nivelin e trajnimit në këtë kurs dhe në kurse të tjera të cilat realizohen në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes". Në këtë ceremoni morën pjesë: zëvendëskomandanti i Komandës



së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) kolonel Irfete Spahiu, përfaqësuesi i Ekipit Ndërlidhës të NATO-s, nënkolonel Zoran Liposhçak, përfaqësues nga Bondstilli, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Po sot, në ambientet e Qendrës Specialistike të Stërvitjes të KDS-së, përfundoi kursi i ndihmës së parë, ku 22 pjesëtarë të komponentit rezervë- aktiv, morën njohuri në lëmin e Ndihmës së Parë. Këtë kurs e realizuan instruktorë të FSK-së, ndërsa interesimi i pjesëtarëve të komponentit rezervë-aktiv ishte jashtëzakonisht i lartë. Komandanti i QSS-së, major Feriz Trezhnjeva, gjatë mbajtjes së ceremonisë, shtoi: "Si në paqe ashtu edhe në situata të jashtëzakonshme, pjesëtarët e çdo ushtrie duhet ta njohin lëndën e Ndihmës së Parë, sepse është një dëshmi e fortë se në disa raste ka ndikuar dhënia e ndihmës së parë për të shpëtuar një jetë". Në të dy kurset u dhanë certifikata si dëshmi për kryerjen me sukses të kurseve për Lider Luftarak dhe të Ndihmës së Parë.

FORCA JONË

* * * Viti IV • Nr. 37 • Gusht 2015 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i FSK-së, Haki Demolli priti Dr. Evelin Farkash, zëvendësasistente e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve

Ministri i FSK-së zoti Haki Demolli, më 13 korrik, priti në orët e pasdites, zëvendës asistenten e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve, Dr. Evelin Farkash. Ai në emër të Ministrisë së FSK-së, Qeverisë dhe popullit të Kosovës i shprehu mirënjohje dhe falënderime për Departamentin e Mbrojtjes dhe SHBA-të, për ndihmën e dhënë dhe për bashkëpunimin kaq të gjerë dhe intensiv. Ministri Demolli, me këtë rast, e njoftoi zonjën Farkash me fushat dhe shkallët e nivelit të bashkëpunimit në mes të Departamentit të Mbrojtjes, Ushtrisë së SHBA-ve me MFSK-në dhe FSK-në.

Duke vlerësuar lartë këtë bashkëpunim ai theksoi Partneritetin për Paqe që ka FSK-ja me Gardën Kombëtare të Ajovës. Fushat e bashkëpunimit janë të shumta si në; programe dhe projekte të ndryshme, trajnime, edukim, donacione materiale dhe financiare si dhe kontributi përmes ekipeve këshilluese për shumë fusha të rëndësishme. Me këtë rast, ministri Demolli e njoftoi mysafiren nga SHBA-të edhe me fushën e bashkëpunimit regjional dhe bilateral me të gjitha shtetet që kanë shprehur gatishmërinë, deri tek ushtrimet e përbashkëta dhe fusha tjera të bashkëpunimit me interes të dyanshëm.

Ai po ashtu e vlerësoi edhe pjesëmarrjen e MFSK-së dhe FSK-së në nismat regjionale të sigurisë, me dëshirën për të dhënë edhe më shumë kontribut në forcimin e sigurisë së përbashkët. Çështje me rëndësi ishte edhe njoftimi i dr.



Farkash edhe me procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK) dhe sfidat aktuale që ekzistojnë me procedurat kushtetuese dhe parlamentare të aprovimit të amendamenteve që kanë të bëjnë me këtë transformim dhe procedimit të projekt Ligjit për Transformimin e FSK-së në FAK. Në fjalën e tij, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama e njoftoi zonjën Farkash me të arriturat në FSK-së, me procesin e përgatitjeve për transformim, sidomos në ato fusha që nuk kanë të bëjnë me vendime politike, për të pritur këtë proces sa më të përgatitur, për çka si ministri dhe FSK edhe e kemi themeluar edhe Departamentin për Transformim. Ndërsa, Dr Farkash shprehi kënaqësinë e saj, me zhvillimet dhe arritjet e FSK-së, me punën që është bërë në përgatitjet për transformim dhe shkallën e gjerë të bashkëpunimit të shumanshëm korrekt dhe konstruktiv, duke theksuar, se Partneriteti për Paqe (PpP) mund të jetë rruga e ecjes përpara drejtë bashkëpunimit me NATO-n. Është me rëndësi që ju të punoni sa më shumë për shtyrjen përpara të agjendës së transformimit, e cila do të hapë rrugë dhe mundësi më të mëdha bashkëpunimi, si në planin bilateral po ashtu edhe në atë multilateral. Në takim, ministri i FSK-së Haki Demolli shoqërohej edhe nga zëvendësministrat: Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, drejtori i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi, shef i Kabinetit të Ministrit, z. Xhevdet Halili, kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri dhe Major Berat Shala-asistent i Komandantit të FSK-së. Nga ana e saj, Dr. Evelin Farkash shoqërohej edhe nga; gjeneral brigade Viliam Hall, nga Komanda e Bashkuar për Evropë, nënkolonel Xhekob Kandelaria nga Komanda e Bashkuar për Evropë, Melisa Henlon nga Zyra e Sekretarit të Mbrojtjes, Shon Krovlej këshilltar për çështje politike dhe ekonomike në Ambasadën e SHBA-ve, në Prishtinë, kolonel Anthoni Bats atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-ve, në Prishtinë, majori Juan Murillo atashe Ushtarak i Ambasadës së SHBA-ve, në Prishtinë dhe major Adam Girouks nga Zyra e Bashkëpunimit të Mbrojtjes e Ambasadës së SHBA-ve, në Prishtinë.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në Konferencën për Siguri në Qendrën "George Marshall" në Gjermani

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 24 korrik 2015, mori pjesë në punimet e Konferencës së dytë për siguri të Evropës të organizuar nga Komanda Evropiane e SHBA-ve për Evropë (EUCOM), që u mbajt në qendrën "George Marshall", në Garmisch të Republikës Federale Gjermane.

Konferenca për siguri kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave në mes të shteteve partnere si dhe çështjet e tanishme dhe të ardhshme të mbrojtjes për tu përballur me kërcënimet bashkëkohore të sigurisë.

Gjithashtu, synim i konferencës ishte edhe avancimi i marrëdhënieve dhe ngritja e bashkëpunimit mes partnerëve evropian dhe SHBA-ve në mënyrë që të arrihen qëllimet e përbashkëta të sigurisë.

Në këtë konferencë, morën pjesë shefat e Mbrojtjes të ushtrive të shteteve të Evropës, oficerë të lartë të EUCOM-it, si dhe komandantët e Gardës Kombëtare të SHBA-ve.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në konferencë, shoqërohej nga kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtarë dhe Sigurisë dhe kolonel Bashkim Shillova, shef i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve në Komandën e Forcave Tokësore, të cilët vitin e kaluar kanë diplomuar në Kolegjin e Luftës në SHBA.



Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar



Ministri Haki Demolli në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar; Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, nënkolonel Richard Parry në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, më 23 korrik 2015, nënshkruan amendamentet e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy Ministrive të dy vendeve. Fillimisht, Ministri Demolli në zyrën e tij, priti në takim atasheun ushtarak Parry me të cilin biseduan mbi të arriturat e FSK-së, fazën nëpër të cilin po kalon FSK-ja, tani në prag të transformimit, si dhe mbi bashkëpunimin e deritanishëm në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes me Mbretërinë e Bashkuar, gjithashtu mbi rezultatet e këtij bashkëpunimi të frytshëm dhe të sinqertë si dhe mbi planet e bashkëpunimit për të ardhmen.

Nga ana e tij, Ministri Demolli e falënderoj atasheun dhe nëpërmjet tij Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë dhe po i japin zhvillimit të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, si në aspektin e shkollimeve, trajnimeve, këshillimeve e gjithashtu edhe për angazhimin e Britanisë së Madhe që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe të zgjerohet në të ardhmen.

Edhe atasheu ushtarak, nënkolonel Parry shprehu zotimin e tij dhe të Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar për vazhdimin e bashkëpunimit dhe përkrahjes së vazhdueshme për Ministrinë e FSK-së dhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në fund, Ministri Demolli dhe atasheu Parry nënshkruan Amendamentin për vazhdimin e Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë se Madhe dhe Irlandës së Veriut. Ky dokument do të jetë në fuqi deri më 2017, ose në rast të ndonjë ndryshimi ligjor në mandatin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Vlen të theksohet se Mbretëria e Bashkuar ka qenë shteti i pare që ka nënshkruar Marrëveshje bilaterale me Republikën e Kosovës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes qysh në vitin 2009.

Gjeneral major Timothy Orr dhe gjenerallejtënant Rrahman Rama vizituan kazermën e FSK-së në Pomozotin



Kazermën "Evropianet e Rinj" në Pomozotin, më 1 korrik 2015, e vizituan komandanti i Gardës Kombëtare të IOWA-s, gjeneral major Timothy Orr së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama. Gjatë kësaj vizite, ata u priten nga kolonel Muharrem Rrahmani, komandant i Brigadës së Mbështetjes Operacionale dhe kolonel Shaip Haziri, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC). Me këtë rast, dy gjeneralët, përmes një prezantimi nga koloneli Shaip Haziri u njoftuan rreth strukturës, trajnimeve dhe të arriturave të përgjithshme të këtij Batalioni. Ndërsa, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr, shprehu kënaqësinë e veçantë për vizitën që po i bënë njësiteve të FSK-së, ku para oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së, mbajti një ligjëratë shumë të frytshme në fushën e zhvillimit profesional të oficerëve. Interesimi për ligjëratën e komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovë gjeneralit Orr, ishte mjaft i madh. Oficerë të Brigadës së Mbështetjes Operacionale dhe njësive të saj, i parashtruan pyetje të shumta gjeneralit Orr. Me këtë rast, gjenerali Timothy Orr u shpreh mjaft i kënaqur me suksesin dhe punën e Regjimentit të Mbrojtjes Civile. "Ky Batalion ka një rëndësi të veçantë për FSK-në, duke pasur parasysh se Institucioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës është institucioni më i respektuar dhe qytetaret ju shohim me besueshmëri dhe admirim, e gjithë kjo është arritur përmes trajnimeve dhe profesionalizmit tuaj" Më pastaj, pjesëtarët e RMC-së, demonstruan disa ushtrime të Kërkim-Shpëtimit Urban, Deminimit dhe të Mbrojtjes kimike Atomike Biologjike (MKAB), ku të gjithë pjesëmarrësit patën rastin të shohin shkathtësitë dhe përgatitjen e pjesëtarëve të këtij Batalioni.

Në këtë vizitë të pranishëm ishin edhe atasheu Ushtarak i Ambasadës së SHBA-ve, në Kosovë, kolonel Antony Butts, shefi i Zyrës së ODC-së kolonel Bruce Murphy, kolonel Muharrem Rrahmani komandant i Brigadës së Mbështetjes Operacionale si dhe pjesëtarë të lartë të FSK-së dhe të ushtrisë të SHBA-ve.

Ministri Demolli falënderoi kolonelin Sarcia për angazhimin e tij për FSK-në



Ministri i FSK-së, zoti Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kanë pritur (28 korrik 2015) në takim lamtumirës, kolonel Salvatore Alessandro Sarcia, nga Italia, këshilltar në Ministrinë për FSK, konkretisht në Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtarë dhe Siguri, me rastin e kryerjes së detyrës së këshilltarit, para largimit të tij, nga Kosova. Me këtë rast, Ministri Demolli e ka falënderuar kolonelin Sarcia për angazhimin dhe për kontributin e tij, në ngritjen dhe profesionalizimin e Ministrisë e me theks të veçantë në angazhimin konkret në Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtarë dhe Siguri, gjatë një vitit, që kolonel Sarcia ka dhënë për Ministrinë, në kuadër të bashkëpunimit të ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Italisë. Kolonelin Sarcia e ka falënderuar edhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rama për angazhimin e tij të palodhshëm gjatë punës një vjeçare në Ministri e gjithashtu edhe për kontributin që koloneli ka dhënë në drejtim të kultivimin të marrëdhënieve të mira në mes të dyja institucioneve dhe dy vendeve tona.

Koloneli Salvatore Sarcia e ka falënderuar ministrin Haki Demolli, komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama si dhe të gjithë oficerët dhe nënoficerët e FSK-së, për ndihmën dhe përkrahjen, gjatë punës në Ministrinë për FSK.

Në fund, Ministri Haki Demolli i dha "Letër-Mirënjohje" për kontributin e tij, në përkrahjen dhe avancimin e MFSK-së dhe FSK-së. Në takim ishte edhe pasuesi i tij, në detyrë, koloneli Francesco Mataarrese, po nga Italia, i cili do të kryej detyrën e këshilltarit në MFSK, për çështje të Bashkëpunimit Ndërkombëtarë dhe Sigurisë.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Demolli dekoroi atasheun ushtarak të SHBA-ve, në Kosovë, majorin Thomas Melton



Ministri i FSK-së, zoti Haki Demolli priti (4 korrik) në vizitë lamtumirëse atasheun ushtarak të SHBA-ve në Kosovë, majorin Thomas Melton. Gjatë shërbimit të tij dy vjeçar në Kosovë, majori Melton ka zhvilluar një aktivitet bashkëpunimi shumë të ngjeshur dhe të pa lodhshëm me MFSK dhe FSK-në. Ministri Demolli e ka dekoruar majorin Melton me medaljen "Shërbimi i shquar", me motivacionin se ai ka dhanë një kontribut të çmuar në ngritjen, zhvillimin dhe procesin e transformimit të FSK-së. Po ashtu me këtë rast edhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama majorit Melton i ka shpreh falënderimin e tij, me "Mirënjohje-Falënderimi" për kontributin e dhanë në zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit në mes të ushtrisë së SHBA-ve dhe FSK-së. Ndërsa, majori Melton shprehu kënaqësinë e tij, që ka pasur rastin të punojë në Kosovë, konkretisht me MFSK-në dhe FSK-në, duke theksuar se ky bashkëpunim ka qenë i dy anshëm dhe shumë i lehtë sepse kamë pasur të bëjë me njërës shumë bashkëpunues dhe profesional.

Nderohet me medalje nënkoloneli amerikan Bruce Murphy



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), Haki Demolli, më 24 korrik 2015, priti në vizitë lamtumirëse shefin e Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë, nënkolonel Bruce A. Murphy, në përfundim të misionit të tij, në Kosovë. Ministri Demolli, me këtë rast, ka falënderuar nënkolonel Murphy, për angazhimin e tij në ngritjen, profesionalizimin si dhe ndihmën materiale të dhënë për Forcën e Sigurisë së Kosovës e në veçanti për Kompaninë e Deminimit të FSK-së si dhe e ka nderuar me medaljen "Shërbim meritor" për kontributin e dhënë në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së. Ndërsa, nënkolonel Bruce Murphy ka falënderuar ministrin Demolli, komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën si dhe të gjithë oficerët e FSK-së, me të cilët ka punuar.
Gjatë takimit lamturmirës, nënkolonel Murphy tha; "Ministrin Demolli, gjeneral Ramën si dhe të gjithë oficerët e FSK-së, të cilët më përkrahën vazhdimisht, me çka pa ndihmën e tyre, nuk do të kisha mundur ta jep kontributin tim, në këtë drejtim. Për këtë jam shumë i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë pjesëtarët e FSK-së".

Ministri i FSK-së, Haki Demolli priti në vizitë lamtumirës këshilltarët e NATO-s: John Cunningham dhe Janez Pate





Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), zoti Haki Demolli, më 24 korrik 2015, priti këshilltarët e NATO-s, në në përfundim të mandatit të tij, në Ministrinë e FSK-së; Major John Cumningham dhe Janez Pate. Ministri Demolli ka falënderuar këshilltarët e Ekipti këshillues të NATO-s, për Ministrinë për Forcën e Sigurisë, major John Cunningham për angazhimin e tij, në ngritjen dhe profesionalizimin e komunikimit dhe të informatikës në Ministrinë e FSK-së dhe Janez Pate për kontributin e dhënë në ngritjen e Prokurimit në kuadër të Ministrisë për FSK-në. Ministri Demolli, këshilltarëve u ka dhënë "Letër Falënderimi" për kontributin e dhënë në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së si përkushtimin e treguar gjatë një viti sa ka shërbyer në MFSK. Në fund, major John Canningham dhe zotëri Janez Pate e kanë falënderuar ministrin Demolli dhe stafin e Ministrisë dhe të FSK-së, Departamentin e Komunikimit dhe të Informatikës si dhe të Prokurimit për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që ka pasur me ta, në ngritjes dhe profesionalizimin e stafit të komunikimit dhe këtij sektori në përgjithësi.

Gjeneral Gëzim Hazrolli diplomoi në kolegjin Mbretëror të Mbrojtjes në Londër

Në Kolegjin Mbretëror të Mbrojtjes në Londër, (College of Depense Studies -RCDS), që është Institucioni më i lartë i Akademisë Ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar dhe ndër më të njohurit në botë, më 2 korrik 2015, mbajti ceremoninë e rregullt të diplomimit të pjesëmarrësve më shumë se pesëdhjetë vendeve të botës. Në këtë akademi, sivjet diplomoi gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i Komandës së Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), pas më shumë se një vit studimesh intensive. Pas pranimit të certifikatës nga komandanti i Kolegjit Mbretëror të Mbrojtjes, Sir Tom Philip KCMG, gjeneral Brigade Gëzim Hazrolli deklaroi se ndjehet krenar dhe i nderuar që është ushtaraku i parë nga Kosova, që diplomoi në këtë akademi me traditë dhe me nam të shquar në mbarë botën. "Shpresoj që edhe në të ardhmen të vazhdojë ky bashkëpunim institucional në mes të Kolegjit Mbretëror të Londrës



dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës", u shpreh në fund, gjeneral Hazrolli.
Në ceremoninë e diplomimit të rreth njëqind ushtarakëve të lartë dhe zyrtarëve shtetërorë nga më shumë se pesëdhjetë vende të ndryshme të botës, ishin të pranishëm edhe familjarët e tyre, si dhe atashe ushtarakë dhe përfaqësues të ambasadave në Londër.

Gjeneral Werner Haumman vlerësoi lartë xhenierët e FSK-së

Komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale(BMO), kolonel Muharrem Rrahmani në ambientet e Kazermës "Adem Jashari" më 15 korrik 2015, priti në një vizitë drejtorin e Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT), gjeneral brigade Werner Haumman.
Kolonel Rrahmani u shpreh i lumtur për vizitën dhe vlerësimin që gjenerali Haumman dhe ekipi i tij kanë shpreh në vazhdimësi për projektet dhe operacionet të cilat i ka zhvilluar Brigada për Mbështetje Operacionale dhe njësitë e saj vartëse.
Nga ana e tij, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Werner Haumman u shpreh se qëllimi i vizitës së tij në Komandën e Brigadës për Mbështetje Operacionale është dëshira për të falënderuar stafin e Brigadës dhe pjesëtarët të cilët në vazhdimësi po japin kontributin e tyre në ndihmë komunitetit në të gjitha lokalitetet e Kosovës pa dallime.
Gjeneral Haumman me këtë rast ai takoi edhe pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të cilët punuan në projektin humanitar për ndërtimin e urës në Manastirin e Deçanit, ku i falënderoj për punën dhe përkushtimin e tyre për t`u dal në ndihmë të gjithë qytetarëve.
Në takimi ishin të pranishëm edhe këshill-



tarja e gjeneralit Haumman njëherë dhe koordinatore e projektit, toger Sandra Pavic Harder, rreshter majori i Brigadës së Mbështetjes Operacionale Besim Berisha si dhe pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të cilët morën pjese në realizimin e projektit punues të urës në Manastirin e Deçanit.
Pjesëtarët u ndanë të kënaqur nga kjo vizitë duke e falënderuar shefin e NLAT gjeneral brigade Haumman dhe ekipin e tij për motivimin dhe mbështetjen e dhënë ndaj pjesëtarëve të Batalionit të Xhenios dhe bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë realizimit të këtij projekti.

Ministri Haki Demolli takoi veprimtarin e çështjes kombëtare Hysen Gega

Ministri i FSK-së, zoti Haki Demolli, priti (3 korrik) veprimtarin e çështjes kombëtare, zotin Hysen Gega nga fshati Sallagrazhdë i Suharekës. Hysen Gega, për shkak të veprimtarisë së tij kombëtare ka qenë dy herë i burgosur dhe i dënuar nga ish shteti i Federatës Jugosllave. Në bazë të ligjit "PËR TË DREJTAT E ISH TË DENUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË" ai ka përfituar nga e drejta për të 'kompensuar' vitet e burgut. Nga shuma e parave të fituara, z. Gega i ka bërë një dhurim (donacion) FSK-së, prej dhjetëmijë (10 000) eurove. Me këtë rast, Ministri Demolli çmoi lartë kontributin e gjeneratave të më hershme, që kanë bërë shumë për çështjen kombëtare dhe çlirimin e vendit. Veçanërisht, Ai çmoi lartë aktin e dhurimit të shumës së



cekur FSK-së, për institucion më të besueshëm dhe më të rëndësishëm të vendit. Ky akt dhurimi është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për shumën e dhuruar, por edhe më i rëndësishëm për simbolikën dhe mesazhin që bartë në vete.



Kadetët e FSK-së me sukses përfunduan ushtrimin fushor ndërkombëtar “Kampingu veror 2015” në Krivollak të Maqedonisë

Më 9 korrik 2015, kadetët e FSK-së përfunduan me sukses operacionet përfundimtare në kuadër të ushtrimit 12 ditor "Kampi Veror 2015" mbajtur në poligonin stërvitor ushtarak në Krivollak të Maqedonisë. Në ditën fundit të ushtrimit fushor, kadetë e të gjitha vendeve pjesëmarrëse përbënin një batalion shumëkombësh, që ishte i ngarkuar me detyra të operimit dhe ndërmjetësimit në mes të dy lokaliteteve që ishin në konflikt mes tyre. Ushtarët dhe eprorët treguan një nivel të lartë të angazhimit, veprimit dhe koordinimi në mes tyre, duke vepruar si njësi unike në realizimin e detyrave të përcaktuara nga skenari i ushtrimit.

Për të përcjellë ditën kryesore të ushtrimit fushor, përveç eprorëve të lartë ushtarak nga shteti mikpritës, kishin ardhur edhe shumë oficerë të lartë nga ushtritë e shteteve tjera, që kishin pjesëmarrës kadetët e tyre në ushtrim. Nga MFSK-ja dhe FSK-ja, ishin të pranishëm gjeneral brigade Zymer Halimi Drejtor i Drejtorisë për Operacione, Kolonel Fadil Hadergjonaj shef i Shtabit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), Ibrahim Shala drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, kapiten Avni Kiçina komandant i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së (QSU) dhe këshilltari i Ekipit këshillues të NATO-s në MFSK kolonel Goran Assarsson.







Ushtrimi fushor "Kampi Veror 2015" organizohet nga Akademia Ushtarake e Maqedonisë, i cili ka karakter ndërkombëtar, ku për çdo vit marrin pjesë kadetët vende të ndryshme, të menaxhuar nga instruktorë të NATO-s dhe të Partneritetit për Paqe (PpP). "Kampi Veror 2015" ka karakter garues, ndërsa FSK-në, e përfaqësojnë 10 kadetë dhe një oficer nga Qendra për Studime Universitare. E veçanta e këtij viti është, se në këtë stërvitje kadetëve të FSK-së nga QSU, ju kanë bashkangjitur edhe kadetët e FSK-së të komuniteteve pakicë që për lehtësira gjuhësore studiojnë në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë, duke bërë një bashkim dhe harmonizim shumë të mirë me kolegët e QSU-së dhe të shteteve tjera gjatë ushtrimit fushor.

Certifikohen kadetët e FSK-së për Kërkim-Shpëtim në ujëra

Pas një periudhe 5 javore të trajnimit në kursin Kërkim-Shpëtim në Ujëra-Zhytje, më 3 korrik 2015, në hapësirat e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së.

Të pranishmit i përshëndeti zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu e cila në fjalën e saj, tha: " ky kurs i cili përfundoi i kompletuar duke realizuar pjesën teorike dhe atë praktike të trajnimit të kërkim-shpëtim në ujëra-zhytje, është një tregues i mirë për përkushtimin e treguar gjatë trajnimit dhe i cili ka qenë mjaft sfidues, nuk duhet vlerësuar për nga numri i pjesëtarëve që e kanë ndjekur kursin, por, për nga rëndësia që ka. Ky kurs, për pjesëtarët e FSK-së, është shumë i rëndësishëm sepse do t'ju shërbejë për të përmbushur misionin në realizimin e detyrave tuaja.

Ne, si KDS mburremi me punën dhe angazhimin tuaj të treguar gjatë këtij trajnimi, si dhe do t'i mbështesim trajnimet e radhës qoftë të këtij niveli, apo të nivelit më të avancuar" përfundoi fjalën e saj, kolonel Spahiu.

Ndërsa, komandanti i Qendrës Specialistike të Stërvitjes (QSS) major Feriz Trezhnjeva, tha: Pjesën teorike e kemi realizuar në ambientet e QSS-së, nga instruktorët tanë, ndërsa pjesën praktike, një javë në pishinën e Banjës së Malishevës, dhe dy javë tjera në Liqenin e Batllavës. Vlen të theksohet se kursi ka qenë mjaft sfidues dhe motivimi i pjesëtarëve të FSK-së, ka qenë shumë i lartë, ku gjashtë kandidatët kanë arritur ta përfundojnë me sukses".



Në ceremoni e diplomimit morën pjesë: zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Fadil Hadergjonaj, përfaqësuesi i Ekipit Ndërlidhës, Këshillëdhënës të NATO-s, nënkolonel Zoran Liposhçak si dhe oficerë dhe nënoficerë të KDS-së.

FSK-ja në stërvitjen regjionale "Joint Reaction 15" në Shqipëri



Një kontingjent i ushtarakëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), 22 korrik 2015 , ka zbarkuar në Republikën e Shqipërisë për të përmbushur misionin e tij në kuadër të ushtrimit të përbashkët simulativ "Reagimi i përbashkët 2015" (Joint Reaction 15"). Kjo stërvitje zhvillohet në kuadrin e Iniciativës "SHBA-Karta e Adriatikut 5", që përfshin vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në ushtrim po marrin pjesë kontingjente të ushtrive nga shtetet e rajonit si Bullgaria , Bosnja e Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, vende të NATO-s si ShBA-ja si dhe Qendra Koordinuese Euro-Atlantike për reagim ndaj Krizave(Euro-Atlantik Disaster Response Coordination Centre).

Pjesë e këtij ushtrim është edhe Republika e Kosovës, e cila ka qenë e përfshirë gjatë gjithë periudhës së planifikimit si dhe pjesë në Ekzekutimin e Ushtrimit. Ushtrim "Joint reaction 15" është ushtrim simulativ që zhvillohet me anë të programeve të veçanta kompjuterike që mundësojnë procedura të reagimit sikurse reagime reale duke mbështetur operacionin ne të gjitha kapacitetet të cilat ofrojnë shtetet pjesëmarrëse.

Forca e Sigurisë së Kosovës ka ofruar kapacitetet e saja Operacionale në Kërkim Shpëtim, pajisje dhe personel për të ndihmuar gjatë operacionit të Shpëtimit, si reagim në raste tërmetesh, dhe si i ftuar i vendit ku ka ndodhur tërmeti, pasi që shteti mikpritës ka shteruar sipas skenarit, kapacitetet e tij reaguese në raste emergjencash.

Gjithashtu si pjesë e skenarit të ushtrimit, në Kosovë është krijuar Qendra Operative Emergjente, në përbërje nga Ministria për Forcën e Sigurisë ,Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme prej nga është përcjell dhe koordinuar puna e ekipeve tona në Shqipëri.

Për të parë nga afër aktivitetet e simuluara të Ushtrimit "Joint reaction 15" për në Republikën e Shqipërisë ka udhëtuar gjeneral Brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në ministrinë për Forcën e Sigurisë, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore(KFT) të FSK-së, kolonel Naim Haziri si dhe Ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë, Ramiz Lladrovci i cili i është bashkuar delegacionit nga Republika e Kosovës.

Qëllimi i ushtrimit është promovimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe sigurisë, rritja e ndërveprimit dhe adoptimi i standardeve, nëpërmjet stërvitjeve të përbashkëta dhe aktiviteteve të bashkëpunimit të njësive respektive. Nga ana tjetër, gjithashtu me rëndësi është edhe bashkëpunimi rajonal, ndihma që duhet t'i japin shtetet njëratjetrës do të forcohet akoma më shumë, duke "shembur mure" dhe "ndërtuar ura" veçanërisht në raste të katastrofave natyrore e njerëzore. Gjithashtu vëmendje të veçantë është kushtuar bashkëpunimit civil-ushtarak; marrëdhëniet me komunitetin, sensibilizimin dhe ndihmën ndaj popullsisë në përballimin e fatkeqësive natyrore.

Ushtrimi "Joint Reaction 2015" është stërvitja e parë e këtij lloji në rajonin e Ballkanit, dhe po ashtu e para e organizuar e drejtuar nën kornizën e Kartës së Adriatikut (A5). Kjo stërvitje u ideua dhe konceptua vitin e kaluar, gjatë kryesimit të Kartës së Adriatikut nga Shqipëria.

Nën kujdesin e drejtpërdrejtë të SHBA, Iniciativa 'Karta e Adriatikut' u lançua në vitin 2003, fillimisht me 3 vendet e rajonit (Shqipëri, Kroaci dhe Maqedoni), dhe u ri dimensionua në vitin 2008 duke përfshirë dhe Malin e Zi e Bosnje dhe Hercegovinën.

Forca e Sigurisë së Kosovës mori pjesë në Ushtrim duke qenë aktor në këtë stërvitje, për të dytën herë nga viti 2013, përkundër faktit se Republika e Kosovës ka statusin e vëzhguesit në kuadër të Iniciativës "ShBA-Karta e Adriatikut (A5)".

FSK-ja në konferencën ndërkombëtare "Barazia Gjinore, Integrimi dhe Perspektiva në Strukturat Ushtarake"

Më 14 korrik 2015, Rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj dhe kapter Valbona Kerolli morën pjesë në Konferencën "SHBA-Karta e Adriatikut 5", me temë "Barazia Gjinore, Integrimi dhe Perspektiva në Strukturat Ushtarake" që u mbajt në Shqipëri nga data 8-10 korrik 2015 në nivelin e nënoficerëve të lartë.

Tema kryesore ishte barazia gjinore, integrimi i gjinisë femërore në strukturat ushtarake dhe në operacione.


Për tri ditë përfaqësuesit e këtyre shteteve prezantuan detaje dhe praktika nga ushtritë e tyre si dhe koordinimin e hapave për bashkëpunim në të ardhmen.

Kjo ngjarje në përgjithësi është dhe një sukses i madh i zhvillimit të trupës së nënoficerëve të FSK-së dhe përfaqësimit ty tyre në arenën ndërkombëtare dhe veçanërisht kontribuon në rritjen e perspektives së gjinisë femërore në FSK.

Në konferencë gjithashtu morën pjesë edhe përfaqësues nga Ushtria Amerikane për Evrope, Garda Kombëtare e New Jersey, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Sllovenia dhe Mali i Zi.



Batalioni i Parë i BRSH-së testoi gatishmërinë operacionale



Pas arritjes së Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO) të FSK-së dhe Direktivës së Komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) për vitin 2015, dhe trajnimin e kompanive të reagimit të shpejtë si forcë e kombinuar për reagim ndaj krizave, dhe fatkeqësive natyrore si rezultat i përfundimit të fazës trajnuese të Kompanisë 1B, është bërë testimi i aftësive operacionale të K1B, bazuar në Listën e Detyrave Esenciale të Misionit (LDEM).

Ushtrimi fushor i Kompanisë 1B ishte i fokusuar mbi bazën e kërkesave të mundshme për mbështetje në situata krize, ku gjatë realizimit të këtij ushtrimi, Kompania 1B, realizoi detyrat në kohë dhe me një profesionalizëm duke qenë e gatshme përherë për pranimin e detyrave tjera. Për të trajnuar në mënyrë sa me të mirë këto detyra ishin simuluar situata të ndryshme që ngjasonin me situata reale dhe ishin tejet sfiduese për personelin.

Ushtrimi fushor "Ujku 1B Godet" ka filluar më 30 qershor 2015 dhe ka përfunduar më 2 korrik 2015, ku është realizuar në perëndim të Gjilanit, në zonën e përgjegjësisë së kompanisë dhe kanë marrë pjesë 143 pjesëtarë, duke përfshirë simulantët dhe stafin e Batalionit të parë.

Ushtrimin fushor e ka përcjellë edhe komandanti i Batalionit nënkolonel Haki Xhemajli, përfaqësues të Ekipit Këshillues të NATO-s (NLAT) dhe vëzhgues nga njësitë tjera. Ushtrimi në tërësi është realizuar me sukses.

Interviste me Azemina Cullum, shefe e Zyrës për Komunitete në MFSK

Pjesëtarët e komuniteteve ndihen mirë në FSK



"Forca Jonë": Cila është Zyra për Çështje të Komuniteteve që ju drejtoni?

Azermina Cullum: Zyra për Çështje të Komuniteteve është themeluar në mars të vitit 2009, me të mbështetjes, promovimit dhe fuqizimit të të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Kosovë gjatë procesit të integrimit në Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK).

"Forca Jonë": Sa keni arrit t'i sensibilizoni pjesëtarët e komuniteteve që të jenë pjesë e FSK-së?

Azemina Cullum: Prej vitit 2009, ne kemi organizuar pesë fushata rekrutuese për pranimin e pjesëtarëve në komponentin aktiv të FSK-së dhe në vitin 2013 është organizuar fushata rekrutuese vetëm për pjesëtarë nga komunitetet pakicë. Rritja e numrit të pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë, ku në FSK në vitin 2009 kemi pasur vetëm nënte pjesëtarë prej komuniteteve etnike, ndërsa sot janë 200, tregon që ne kemi arritur ta përmbushim objektivin tonë, e kemi ngritur vetëdijen dhe interesimin e pjesëtarëve, e në veçanti atyre nga komuniteti serb për t'ju bashkuar FSK-së. Ne kemi dashur të tregojmë që FSK-ja është institucioni me i besueshëm dhe sigurisht, dëshirojmë që këtë besim ta ruajmë dhe ta ngremë tek të gjithë qytetarët e Kosovës. Megjithatë, ne duhet të jemi të vetëdijshëm që dëshmia e integrimit të suksesshëm nuk është vetëm numri i komuniteteve, por edhe respektimi i të drejtave të tyre, krijimi i ambientit për qëndrimin e komunitetit tanimë të integruar, sigurimin e kushteve të barabarta të punës. Duke pasur parasysh që pozitat e disa komuniteteve jo shumicë siç janë: romët, egjiptianët, ashkëtinjtë vazhdon të jetë e vështirë, ne përpiqemi ta avancojmë pozitën e tyre duke ju ofruar mundësi për punësim, avancim dhe zhvillim të karrierës duke i respektuar të drejtat të cilat ju takojnë.

"Forca Jonë": Cili është bashkëpunimi i juaj me komunat në përgjithësi dhe në veçanti me ato të komuniteteve?

Azemina Cullum: Ne kemi krijuar dhe siguruar një bashkëpunim të suksesshëm me komuna, dhe veçanërisht me zyrat komunale për komunitete të cilat gjatë procesit të rekrutimit paraqesin një prej bashkëpunëtorëve shumë të rëndësishëm. Komunat janë një lloj lidhje në mes të të rinjve dhe zyrës sonë, të cilët na mbështesin dhe na ndihmojnë në organizimin e takimeve me të rinjtë, ofrojnë informata dhe i inkurajojnë të rinjtë të aplikojnë në FSK. Po ashtu, bashkëpunimi ynë me komuna është i lidhur suksesshëm përmes Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak. Në komunat me komunitetet jo shumicë, deri më tani kemi realizuar rreth 40 projekte humanitare në fushën e infrastrukturës. Po ashtu dua të theksoj që kemi bashkëpunim shumë të mirë me Zyrën për Komunitete në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të republikës së Kosovës si dhe me organizatat ndërkombëtarë të cilat veprojnë në Kosovë.

"Forca Jonë": Cili është numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të komuniteteve në FSK-së dhe niveli i tyre?

Azemina Cullum: Numri i përgjithshëm, për momentin në FSK, prej 2348 pjesëtarëve të komponentit aktiv, 200 prej tyre janë nga radhët e komuniteteve, shprehur në përqindje; 8.39%. Përqindja e pjesëtarëve që vinë nga komuniteti serb është 1.97%, atë boshnjak është 1.89%, nga komuniteti turk 2.27%. nga komuniteti rom janë 3 pjesëtarë, 14 pjesëtarë egjiptianë, 29 ashkali, 2 pjesëtarë vijnë nga komuniteti goran dhe 4 nga ai kroat. Grada më e lartë nga pjesëtarët e komunitetit jo shumicë është ajo e majorit.




"Forca Jonë": Sa janë të arsimuar pjesëtarët e komuniteteve sot?

Azemina Cullum: Në FSK është arritur një përparim shumë i madh, në shkollimin e pjesëtareve të komunitetit jo shumicë. Qendra për Trajnime dhe Doktrinë në Ferizaj, e mbështetur edhe nga komuniteti ndërkombëtar, ka fuqizuar programin e saj dhe ka arritur profesionalizëm në shkollimin e pjesëtarëve të FSK-së. Falë kësaj, pjesëtarëve të FSK-së përmes trajnimeve të ndryshme, kurseve, programeve arsimore iu kanë ofruar mundësi të barabarta për shkollim dhe prosperitet. Pjesëtarët e komunitetit serb dhe boshnjak janë ballafaquar me problemin e mosnjohjes së gjuhës shqipe. Siç e dini, gjuha është problem i cili vërtet e vështirëson procesin e integrimit dhe tek të rinjtë në Kosovë paraqet barrierë në avancimin e karrierës dhe të shkollimit. Vitin e kaluar e kemi organizuar kursin e gjuhës shqipe për 39 pjesëtarë nga komuniteti serb dhe ai boshnjak i cili është treguar mjaft i suksesshëm, andaj kemi arrit në përfundim që kurse të tilla duhet të vazhdohen edhe në të ardhmen. Mosnjohja e gjuhës angleze tek pjesëtarët e komuniteteve krijon barriera në zhvillimin e karrierës, e që është një prej arsyeve kryesore që në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, në Prishtinë, nuk kemi asnjë pjesëtarë prej komunitetit jo shumicë. Megjithatë, është e rëndësishme të ceket që është krijuar një bashkëpunim rajonal me Maqedoninë dhe me Kroacinë të cilat na ofrojnë mbështetje të plotë në shkollimin e pjesëtarëve të FSK-së, dhe në veçanti të komuniteteve jo shumicë. P.sh. në Akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostolski", në Shkup, kemi nëntë kadetë; tre prej tyre janë të komunitetit serb dhe pesë të atij boshnjak dhe një nga komuniteti shqiptar. Edhe këtë vit shkollor 2015/2016 do t'i dërgojmë për shkollim, tre kadetë në Maqedoni, dy në Kroaci dhe shtatë në Turqi.

"Forca Jonë": Cili është projekti i juaj për të ardhmen?

Azemina Cullum: Ne do ta vazhdojmë punën tonë në integrimin e komuniteteve dhe veçanërisht në qëndrueshmërinë e komuniteteve tanimë të integruara. Duhet ta mbajmë në mend që MFSK dhe FSK-ja, në bashkëpunim me institucione qeveritare dhe aktorët ndërkombëtarë në Kosovë, duhet vazhduar me promovimin e rëndësisë së integrimit të komuniteteve në sektorin e sigurisë. Do të përpiqemi edhe këtë vit, të jemi transparent në punën tonë për të treguar që FSK-ja është forcë e besueshme dhe një mundësi e mirë për prosperitet për të gjithë të rinjtë e Kosovës, pavarësisht nga gjinia dhe nga përkatësia e tyre etnike! Janë të planifikuara disa projekte për vazhdimin e kurseve të gjuhës, fuqizimin e rolit të femrës nga radhët e komuniteteve dhe sigurisht, takimet e rregullta me komunitetet jo shumicë në FSK! Në fund dua t'i falënderoj të gjithë kolegët e mi, Ministrin e MFSK-së, Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Sekretarin e Përgjithshëm të MFSK-së, ekipin e NATO-s, si dhe ekipin e zyrës sime, për gjithë mbështetjen e ofruar gjatë këtyre viteve pune, sepse suksesi i ynë nuk do të ishte i mundur pa ta!

Ministri Demolli përuroi urën e ndërtuar nga FSK-ja afër Manastirit të Deçanit



Ministri Haki Demolli dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 15 korrik, morën pjesë në inaugurimin e urës të cilën në kohë rekord e ka montuar gjatë këtyre ditëve Batalioni i Xhenios së FSK-së për nevoja të Manastirit të Deçanit, popullatës lokale atje si dhe trupave të KFOR-it gjatë patrullimeve në zonë.
Batalioni i Xhenios i FSK-së me vendim të Ministrit, Haki Demolli dhe Urdhër të Komandantit, gjeneral Rrahman Ramës ka qenë e angazhuar në implementimin e këtij projekti që nga 15 qershori e deri më 3 korrik 2015. Në këtë projekt kanë punuar gjithsejtë 23 pjesëtarë të FSK-së. Vlen të theksohet se i terë materiali i urës ka qenë donacion i dhuruar nga Kontingjenti italian i KFOR-it e gjithashtu edhe trajnimi dhe përgatitje e pjesëtarëve për të montuar këtë model të urës.
Kohë më parë Kontingjenti italian i KFOR-it në Pejë pati drejtuar një kërkesë ministrit të FSK-së Haki Demollit që nëpërmjet Komandantit të FSK-së të angazhojë Batalionin e Xhenios të FSK-së të përgatitet dhe të kryej vendosjen e urës në lokacionin e caktuar paraprakisht. Për këtë qëllim, Kontingjenti ushtarak italian i KFOR-it pati ndarë si donacion skeletin e urës si dhe trajnimin për pjesëtarët që do të punonin në vendosjen e saj.
Në ceremoninë e inaugurimit sot, morën pjesë edhe kryetari i Komunës së Deçanit, Rasim Selmanaj, komandanti i KFOR-it. Gjeneral major Francesco Paolo Figliuolo, klerikët fetar të Manastirit si dhe personalitete tjera vendore dhe ndërkombëtare.
Përpos ndihmës për përmirësimin e cilësisë së jetës, qëllimi i projektit është edhe zgjerimi i bashkëpunimit me KFOR-in, autoritetet civile si dhe institucionet e vendit në bazë të misionit që aktualisht ka Forca e Sigurisë së Kosovës.

Në KDS certifikohen kadetët e Kursit Bazë të Nënoficerit



Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në Ferizaj, m% 13 korrik përfundoi "Kursi bazë i nënoficerit" me ç 'rast u mbajt edhe ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së që ndoqën këtë kurs.
Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishin zëvendëskomandanti i KDS, kolonel Irfete Spahiu, shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Fadil Hadërgjonaj, major Paolo Ruso përfaqësues i Ekipit Ndërlidhës Këshillëdhënës të NATO-s, oficer dhe nënoficerë FSK-së.
Të pranishmit i përshëndeti zëvendëskomandanti i KDS kolonel Irfete Spahiu e cila në fjalën e saj i përgëzoj të gjithë kursantët për një punë të pa lodhshme rezultatet e të cilës po i shohim sot para nesh. Kjo, tha kolonel Spahiu është edhe një dëshmi se FSK çdo ditë po shkon drejt profesionalizmit, andaj kjo ceremoni dhe ky certifikim është dëshmia më e mirë që ju sot mund të na tregoni. Në fund, zëvendës komandantja Spahiu tha se programi që ju keni vijuar është hartuar në përputhje me kërkesat për zhvillimin e karrierës të gradës së tetarit në FSK, i cili ofron për ushtarët profesionist hapësira të reja për zhvillimin e kapaciteteve intelektuale, rritjen e shkallës së gjykimit dhe të aftësive për të marr përsipër detyra të rëndësishme, drejtimi dhe udhëheqje individuale tashmë si nënoficer në FSK.
Ky kurs ka filluar më 8 qershor dhe po përfundoi më 10 korrik 2015, ndërsa kursin e kanë ndjekur 37 pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së, kurs ky i cili u shërben për tu avancuar në gradën e tetarit në FSK. K j o është gjenerata e parë 2015 e realizuar në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, në të cilin u certifikuan 37 pjesëtarët e FSK-së, ndërsa shpërndarjen e certifikatave e bënë ZVKOMKDS kolonel Irfete Spahiu dhe nënkolonel Adem Hagjosaj, komandant i Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve.
Gjithashtu, për pjesëtarët e dalluar u ndanë mirënjohje.

FSK-ja zgjeroi oborrin e shkollës fillore "Daut Rexhepi" në Shtërpcë

Batalioni i Xhenios (BXH) i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) të FSK-së me një punë të shkëlqyer ka arritur që për dhjetë ditë të realizoj projektin humanitar për rregullimin e hapësirës së oborrit të shkollës dhe fushës së sportit në fshatin Viqë, të Komunës së Shtërpcës, projekt ky që FSK-ja e realizon në ndihmë komunitetit.
Projektin të cilin FSK-ja e ka realizuar në të mirë të nxënësve dhe mësimdhënësve të Shkollës fillore të Mesme të Ulët "Daut Rexhepi" ka qenë i nevojshëm sepse mundëson që hapësirat të jenë të shfrytëzueshme për aktivitete shkollore. Hapësira në të cilat FSK-ja ka punuar, pra oborri ka 56 metra gjatësi dhe 15 metra gjerësi si dhe fusha e sportit me dimensione 59 metra gjatësi dhe 16 metra gjerësi ku është bërë rrafshimi dhe nivelimi i fushës. Punimet në Viqë i kanë vizituar drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, Hajrush Kurtaj bashkë me Fadil Vojvodën, kapiten në Sektorin për Bashkëpunim Civilo Ushtarak në Komandën e Forcave Tokësore ku janë takuar me nënkryetarin e Komunës, Beqir Fejzullahu, zëvendës drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit z. Sadik Imeri si dhe drejtoreshën e SHFMU "Daut Rexhepi", Ganimete Gjemajli, të cilët janë shprehur shumë të kënaqur më punimet e FSK-së në këtë projekt dhe kanë falënderuar ushtarët e FSK-së, MFSK, FSK-në si dhe DBCU-së për realizimin e këtij projekti.
Forca e Sigurisë së Kosovës në vazhdimësi është duke realizuar projekte në ndihmë komuniteteve me kapacitetet e saja ekzistuese, përfshirë edhe këtë projekt i cili u realizua dhe menaxhua nga Batalioni i Xhenios me kapacitete dhe investimin të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për realizimin e së cilit kishte angazhuar 8 pjesëtarë, 6 automjete të llojeve të ndryshme sikurse xhipa, kamion transportues, greder dhe ekskavator. Xhenio e FSK-së gjatë kësaj kohe ka bërë bartjen e 80 kamionëve materialit si dhe rregullimin e ambientit për gjithsejtë 8 ditë pune.
Projekti humanitar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Daut Rexhepi" ka filluar më 30 qershor dhe ka përfunduar më 10 korrik të këtij viti duke krijuar një ambient të përshtatshëm për lojë dhe pushim të nxënësve.



Batalioni i Xhenios rregulloi fushën e futbollit në fshatin Izvor të Artanës

Batalioni i Xhenios (BXH) i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), përfundoi edhe një projekti humanitar në fshatin Izvor të komunës së Artanës, projekt ky që është plotësisht në shërbim të komunitetit lokal që jeton atje.
Batalioni i Xhenios për tri ditë ka arritur të realizojë me sukses projektin humanitar, rregullimin dhe nivelimin e fushës së sporteve (futbollit të madh) të cilët, nga kjo, do të përfitojnë të rinjtë e këtij fshati me popullatë shqiptare dhe serbe.
Batalioni i Xhenios ka realizuar rrafshimin dhe nivelimin e fushës së futbollit të madh, si dhe hapjen e kanalit anësor. Qëllimi i realizimit të këtij projekti humanitar nga Batalioni i Xhenios është që qytetarët e Kosovës të përftojnë nga mbështetja e FSK-së, dhe nga projektet humanitare të FSK-së, të cilët janë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës.
Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, Hajrush Kurtaj ka përshëndetur dhe falënderuar pjesëtarët e Batalionit të Xhenios, të cilët me një punë shumë profesionale kanë arrit që në afatin e paraparë të realizojnë edhe këtë projekt që është plotësisht në shërbim të të rinjve të këtij fshati. Batalioni i Xhenios në realizimin e këtij projekti ka angazhuar pesë pjesëtarë të saj, me pesë automjete; kamionë, grejder, ekskavator, ku kanë rrafshuar mbi 5000 metra katror, dhe kanë hapur mbi 160 metra kanale anësore.
Forca e Sigurisë së Kosovës në vazhdimësi është duke realizuar projekte në ndihmë. Ky projekt ka filluar më 21 korrik dhe ka përfunduar më 23 korrik 2015. Fushën e futbollit do ta shfrytëzojnë të rinjtë e këtij fshati.



Në FSK u mbajt seminari "Këmbimi i informacioneve të logjistikës"

Në repartet e Kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore, më 20 korrik, u mbajt ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve të FSK-së, vijues të seminarit "Këmbimi i informacioneve të logjistikës" të mbajtur nga ekspert të kësaj fushe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht shtetit Aiova (IOWA).

Seminarin e kanë udhëhequr nënkolonel Leon B. Altman, nënkolonel Wesley R. Golden, Rreshter David E. Kabisch, shef Michelle L. Clevenger, rreshteri i klasit të parë Matthew A. Jones. Punimet e aktivitetit u mbajtën nga data 13-16 korrik dhe u zhvilluan këto tema: vlerësimet, përllogaritjet dhe parashikimet logjistike, ritmi i betejës, përditësimi i shkurte i komandës, procesi ushtarak i vendimmarrjes dhe vlerësimi i kurseve të veprimit.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin shefi i Operativës së Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Bashkim Shillova ,ushtruesi i detyrë së Komandantit të Brigadës së Mbështetjes Operacionale, kolonel Muharrem Rrahmani.

Kolonel Rrahmani, në emër të Komandantit të FSK-së, gjeneral Rrahman Ramës, i falënderoi instruktorët nga Aiova për kontributin e dhënë në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së e në veçanti të logjistikës së FSK-së dhe njëherit tha se ndjehet i lumtur që po sheh pjesëtarë nga të gjitha njësitë e FSK-së dhe se njohuritë e fituara jam i bindur u shpreh Ai se do t`i shpërndani tek vartësit tuaj, gjithashtu kolonelët Rrahmani e Shillova ndanë mirënjohje për instruktorët amerikan.

Nënkoloneli Leon B Altman theksoj përkushtimin e pjesëtarëve të FSK-së në këtë trajnim, ku ky përkushtim potencoj Ai tregon gatishmërinë për ecje përpara të



institucionit dhe me këtë rast edhe falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin e treguar si dhe mikpritjen.

Në fund u ndanë certifikata për të gjithë pjesëmarrësit në trajnim .

Brigada për Reagim të Shpejtë përfundoi trajnimin "Taktikat me njësi të vogla"

Në Kazermën "Ushtarët e NATO-s", të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), më 20 korrik, në Istog, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 46 pjesëtarëve pas përfundimit të trajnimit "Taktikat me Njësi të Vogla", të gjeneratës së tretë për vitin 2015.

Në ceremoni morën pjesë: Ushtruesi i detyrës së Komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, ushtruesi i detyrës së shefit të Shtabit, major Ejup Maqedonci, komandantët e tri Batalioneve të Reagimit të Shpejtë, përfaqësues nga KFOR-i slloven dhe nga Ekipi Ndërlidhës Këshillues i NATO-s për FSK-në (NLAT-it).

Me këtë rast pjesëtarëve që u certifikuan i'u drejtua kolonel Xhevahir GECI, i cili i përgëzoi për rezultatet e treguara, angazhimin, motivimin



dhe vullnetin që treguan gjatë aktiviteteve të trajnimit. Ndër tjera, kolonel GECI theksoi se: "Trajnimi "Taktikat me Njësi të Vogla" është një ndër aktivitetet kryesore dhe më të rëndësishme që zhvillohet në Brigadën e Reagimit të Shpejtë". Ky trajnim, shtoi kolonel Geci është i rëndësisë së veçantë sepse në kuadër të këtij trajnimi, ligjërohen dhe praktikohen tema ushtarake të cilat janë unike për BRSh-në dhe FSK-në. Në fund kolonel Xhevahir Geci tha se trajnimi "Taktikat me Njësi të Vogla" është trajnim i cili do të mbetet prioritet i BRSH-së edhe pas transformimit në Forcat e Armatosura. Temat që praktikohen në këtë trajnim janë tema që do të trajnohen edhe në misionin e ardhshëm, prandaj është shumë e rëndësishme për BRSH-në të mbajë dhe avancojë nivelin e këtij trajnimi".

Krejt në fund, ushtruesi i detyrës së komandantit të BRSH-së i uroi të gjithë pjesëtarët për përfundimin me sukses të trajnimit "Taktikat me Njësi të Vogla', dhe kërkoj nga pjesëtaret që të mirëmbajnë shkathtësitë që përfituan nga ky trajnim dhe që këto njohuri ti shpërndajnë dhe zhvillojnë në njësitë e tyre si dhe ti përdorin ato gjatë trajnimeve dhe ushtrimeve në FSK. Gjatë këtij trajnimi pjesëtarët janë pajisur me njohuri, në teori dhe në praktikë, në fusha të ndryshme, ndërsa fokusi kryesorë gjatë trajnimit ka qenë ngritja dhe profesionalizimi i pjestarëve të BRSH-së dhe njësive tjera të FSK-së për kryerjen e detyrave taktike për realizimin sa më mirë të misionit të tanishëm dhe atë të ardhshëm.

Ndër temat me të veçanta janë trajtuar: Aftësimi i pjesëtarëve në udhëheqje dhe operim me ekipe dhe skuadra, patrollat, rikonicion, repilim, navigim tokësor i kombinuar ditën dhe natën, prita, reagimi në kontakt, qitja taktike dhe stresuese me armë, operacione urbane dhe tema tjera që janë po ashtu të një rëndësie të veçantë për FSK-në në përgjithësi.

Trajnimi "Taktikat për Njësi të Vogla" ka filluar me 15 Qershor dhe ka përfunduar me 16 Korrik të këtij viti. Në kuadër të pjesëmarrësve në trajnim, përveç pjesëtarëve të tri Batalioneve të BRSH-së, kanë marrë pjesë edhe 5 pjesëtarë të BMO-së.

Batalioni i Dytë i BRSH-së realizoi ushtrimin "Ujku në veprim"

Kompania 2A e Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagimit të Shpejtë pas realizimit me sukses të Ushtrimit fushor "Ujku në veprim" ka përmbyllur programin e trajnimit të brendshëm tre mujor të gjenerimit të forcës (14 prill 09 korrik 2015). Ushtrimi fushor u realizua pas përfundimit të trajnimit për gjenerim të forcës.

Në aktivitetet e ushtrimit dhe për realizimin e tij sipas objektivave të paraparë, në lokalitetin e Lugut të Baranit të komunës së Pejës u dislokuan për 3 ditë, 118 pjesëtarë me 20 automjete ushtarake duke përfshirë edhe blinda.

Gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e Kompanisë 2A janë sfiduar fizikisht me patrullime natën dhe ditën, navigim tokësor dhe lëvizje në terren të thyeshëm me vegjetacion të dendur dhe tema tjera ushtarake, me ç 'rast treguan vendosmëri dhe motivim jashtëzakonshëm.

Ushtrimi në përgjithësi ishte produkt i trajnimit tre mujor të Kompanisë, ku gjatë kësaj kohe pjesëtarët e kompanisë i rifreskuan temat taktike profesionale ushtarake. Për më tepër ky ushtrim dëshmon që kjo njësi është përgatitur dhe ka kapacitet të ekzekutoj operacione si njësi e pavarur në terren.

Gjatë ushtrimit pjesëtarët e Kompanisë 2A dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht në fushën



e operacioneve ushtarake, siç janë Patrullimet, Prita, Kërkim dhe koordon, Baza patrulluese, Rikonicion të terrenit, Reagim në kontakt me armikun, Sulm në nivel togu, Shkëputje të kontaktit, Pika të kontrollit dhe Patrullim me automjete-aotblinda.

Gjatë planifikimit dhe zbatimit të këtij ushtrimi fushor çdo detaj ka funksionuar në bazë të Procedurës së Udhëheqjes së Trupave.

Trajnimet janë planifikuar nga Komanda e Batalionit të Dytë dhe janë duke u zbatuar në nivel Kompanie, si dhe janë mbështetur dhe vlerësuar nga Komanda e Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë, ekipet këshilluese të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT) dhe ekipet vlerësuese të Brigadës për Reagim të Shpejtë.

Batalioni i Tretë për Reagim të Shpejtë zhvilloi me sukses ushtrimin "Majdani taktik"



Në kuadër të gjenerimit të forcës, Kompania 3A e Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë të BRSH-së, ka zhvilluar ushtrimin taktik "Mejdani taktik", nga data:20-24 korrik 2015, trajnim ky i cili pritet të përmbyll aktivitetet me ushtrimin fushor "Veprimi i shpejtë 05" i planifikuar të mbahet në gusht të këtij viti.

Ushtrimi u mbajt në Shalë të Bajgores, në një terren kodrinor malor me një lartësi mbidetare deri 1500 metra, ku, morën pjesë 90 pjesëtarë me 12 automjete ushtarake. Gjatë këtij ushtrimi, pjesëtarët e Kompanisë 3A, dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht në operacionet ushtarake, siç janë: Operacionet defensive, Patrullimet natën dhe ditën (Rikonicioni luftarak dhe Rikonicioni i sigurisë), Baza Patrulluese dhe Procedura e udhëheqjes së trupave. Pjesëtarët treguan vendosmëri dhe moral të lartë për realizimin e misionit. Trajnimi është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Tretë dhe zbatuar në nivel Kompanie, ku janë mbështetur dhe vlerësuar nga Komanda e Batalionit të Tretë, Ekipet Ndërlidhëse Këshilluese të NATO-s, (NAT).

Për më tepër ky ushtrim dëshmoi që Kompania 3A e Batalionit të 3-të është përgatitur dhe ka kapacitete të ekzekutojë operacione si njësi e pavarur në terren. Ushtrimin fushor "Majdani taktik"e përcolli për së afërmi shefi i Shtabit i Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, shefi i Shtabit i Brigadës së Reagimit të Shpejtë major Ejup Maqedonci dhe oficerë të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s.

FORCA JONË

∗ ∗ ∗ Viti IV • Nr. 38 • Shtator 2015 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës ∗ ∗ ∗

Ministri Haki Demolli priti në takim lamtumirës zv.drejtorin e NAT-it kolonel Tom Staton

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli, priti në takim lamtumirës kolonelin Tom Staton, zëvendësdrejtor i Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK, i cili këto ditë përfundoi misionin e tij njëvjeçar në Kosovë. Me këtë rast, ministri Demolli në shenjë falënderimi për punën e palodhur të kolonelit Staton gjatë angazhimit të tij si këshilltar në MFSK dhe për bashkëpunimin e gjithanshëm, në emër të Ministrisë i dha një Letër Falënderimi, me anë të së cilës ai shprehu mirënjohjen e tij për punën dhe angazhimin e ushtarakëve amerikanë në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ndërsa, koloneli Tom Staton u shpreh falënderues për bashkëpunimin, koordinimin si dhe ambientin e punës që i është krijuar në Ministri nga stafi drejtues si dhe bashkëpunëtorët e tjerë, duke shtuar se pikërisht ky bashkëpunim dhe mirëkuptim ka ndikuar që rezultatet çdo ditë e më tepër të jenë më të prekshme edhe të matshme. Koloneli Staton u shpreh i bindur se edhe pasardhësi i tij në detyrë do të vazhdojë ta kryejë me përkushtim mandatin e tij në Ministri në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s. Ekipi këshillues i NATO-s (NAT) është trupë e formuar nga NATO-ja, me mision këshillimin profesional të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Të gjitha vendet anëtare të NATO-s emërojnë ushtarakë dhe personel civilë si këshilltarë në kuadër të NAT-it, ku drejtori emërohet nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, ndërsa zëvendësdrejtori çdo herë emërohet nga Garda Kombëtare e Ajovës, me të cilën jemi si dy shtete në partneritet.



Forca e Sigurisë së Kosovës institucioni më i besueshëm i sigurisë në Kosovë



Instituti Kosovar për Zhvillim të Politikave (KIPRED), mbajti, më 10 gusht 2015, tryezën e rrumbullakët me temën" Monitorimi i Sektorit të Sigurisë së Kosovës gjatë muajve prill-korrik 2015-të," në Prishtinë, ku ka nxjerrë Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policinë e Kosovës si institucionet më të besueshmen për qytetarët e Kosovës. Në këtë tryezë morën pjesë: gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione, Krenare Sogojeva, drejtoreshë e Departamentit Ligjor, z. Dominic Braithwaite, drejtor i NAT-it për FSK-në, si dhe përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të Punëve të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, përfaqësues të shoqërisë civile, të medieve etj. Ky është edicioni i parë i Observerit të Sektorit të Sigurisë së Kosovës, ku trajtoi mënyrën analitike, çështjet kyçe të sektorit të punëve të brendshme, inteligjencës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Me një punim të veçantë u trajtua edhe analiza e politikave publike për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK). Po ashtu, u prezantuan rezultatet e hulumtimit të opinionit publik, në lidhje me besueshmërinë në çështje të sigurisë të institucioneve përkatëse qeveritarëve dhe krerët e tyre, si dhe Komisionet Parlamentare. Tryezën e rrumbullakët e udhëhoqi drejtori ekzekutivë i KIPRED-it, z. Lulzim Peci, ndërsa për rezultatet e besueshmërisë së opinionit ndaj institucioneve të sigurisë në Kosovë, raportin e hulumtimit e paraqiti Mentor Agani, hulumtues i lartë. Tryezën e rrumbullakët me diskutimet e tyre përmbajtjesore e ndihmuan edhe gjeneral brigade Zymer Halimi, Krenare Sogojeva-Dermaku, Dominic Braithwaite, si dhe përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Siguri, përfaqësues të Shoqërisë së Lirë, të Mediave etj..

Sipas zotit Agani, në seksionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, janë analizuar në lidhje me transformimin e FSK-së në FAK çështjet e procedurave rreth operacioneve të FSK-së në veri, dhe subordinimi i kreut të tij ndaj autoriteteve civile, si dhe janë prezantuar të gjeturat nga hulumtimi i opinionit publik në lidhje me besueshmërinë e qytetarëve për çështje të sigurisë ndaj Ministrisë së FSK-së dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Sipas këtij hulumtimi të opinionit; qytetarët e Kosovës më së shumti i besojnë FSK-së, pastaj Policisë së Kosovës etj.

Në anketë janë përfshirë 1000 të anketuar që janë përgjigjur në pyetjen:"Sa u besoni institucioneve të mëposhtme lidhur me çështjet e sigurisë". Dy notat më të larta i janë dhënë FSK-së (4.00) dhe Policisë së Kosovës (3.79) etj. Tryeza e rrumbullakët i përmbylli punimet me pasqyrën analitike të hulumtimit të opinionit publik për institucionet më të besuara të Kosovës.

FSK-ja në ushtrim fushor në Kroaci dhe Slloveni

Një Kontingjent i FSK-së, nga data: 06 - 22 Shtator 2015, po merr pjesë në Ushtrimin fushor "Reagimi i Menjëhershëm" në Republikën e Kroacisë dhe Sllovenisë. Ushtrimi "Reagimi i Menjëhershëm" është organizuar nga Forcat e Armatosura të Kroacisë dhe asaj të Sllovenisë në përkujdesjen e Ushtrisë Amerikane për Evropë (USAREUR). Në këtë ushtrim po marrin pjesë vendet e ndryshme të rajonit. Qëllimi i mbajtjes së këtij ushtrimi është ngritja e nivelit profesional dhe i koordinimit të aktiviteteve të tyre.




Ministri i FSK-së, z. Demolli çmoi lartë angazhimin e oficerëve nga Turqia gjatë misionit në MFSK dhe FSK



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli, priti sot në takim lamtumirës oficerët e lartë të Forcave të Armatosura të Turqisë, të cilët për një vit shërbyen në Republikën e Kosovës, përkatësisht në MFSK dhe FSK, në misionin e këshilltarëve ushtarakë në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s (NAT), Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT) si dhe në kuadër të Kontingjentit turk të KFOR-it. Në takim së bashku me ministrin Demolli ishin të pranishëm edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i kontingjentit turk në kuadër të KFOR-it, kolonel Gultekin Yarali, këshilltar ushtarak i ministrit dhe komandantit të FSK-së, si dhe koloneli Rafet Kiliç, këshilltar ushtarak për Ministrinë në kuadër të NAT-it. Me këtë rast, ministri Haki Demolli në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për bashkëpunimin, koordinimin dhe forcimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve në mes të MFSK-së/FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Turqisë, në emër të Ministrisë, për oficerët e lartë turq, ndau nga një Certifikatë Falënderimi. Po ashtu, në shenjë respekti për kontributin e oficerëve turq gjatë misionit të tyre në Kosovë, e në veçanti për angazhimin e tyre në kuadër të Ekipeve të NATO-s për këshillimin e Ministrisë dhe të Forcës, simbolikisht me nga një Mirënjohje i nderoi edhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerali Rrahman Rama. Nga ana e tij, kolonelët Demircioglu, Yarali dhe Kiliç shprehën falënderimin për mikpritjen nga ana e MFSK-së dhe FSK-së dhe gatishmërinë për bashkëpunim gjatë gjithë misionit të tyre në Republikën e Kosovës me theks të veçantë në MFSK dhe FSK.

Oficerët u shprehën falënderues për bashkëpunimin, koordinimin si dhe gatishmërinë e ministrit dhe të komandantit, e gjithashtu edhe të stafit tjetër të Ministrisë dhe Forcës për kultivimin e një raporti shumë frytdhënës në të gjitha fushat të cilat janë të rregulluara edhe me marrëveshje bashkëpunimi në mes dy ministrive dhe dy vendeve tona. Kolonelët turq, të cilët pas kthimit në atdheun e tyre do të marrin detyra të reja në kuadër të Forcave të Armatosura të Turqisë, shprehën gatishmërinë për të qenë zë i Ministrisë dhe Forcës atje, si dhe kurdoherë të gatshëm të përkrahin Ministrinë, FSK-në dhe Republikën e Kosovës në synimet e saj për një Forcë moderne dhe bashkëkohore.

Ministri Demolli priti në takim lamtumirës kolonelin Hasan Aydoglu





Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli, priti në një takim lamtumirës atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë, në Republikën e Kosovës, kolonelin Hasan Aydoglu, i cili këto ditë përfundon misionin e tij në Kosovë. Në takim ishin të pranishëm edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shef i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Siguri, koloneli Ilir Qeriqi. Me këtë rast, ministri Demolli në shenjë falënderimi për bashkëpunimin, koordinimin dhe forcimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve në mes të Ministrisë së FSK-në dhe FSK-së me atë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Turqisë, si dhe për gatishmërinë e gjithanshme, i ndau në emër të Ministrisë një Certifikatë Falënderimi, me anë të së cilës Ai i shprehu atasheut turk gjithë mirënjohjen e tij për punën, angazhimin si dhe për kontributin e dhënë në kuadër të korit të atasheve në dobi të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Nga ana e tij, koloneli Hasan Aydoglu u shpreh falënderues për bashkëpunimin, koordinimin si dhe gatishmërinë e ministrit dhe të komandantit, e gjithashtu edhe të stafit tjetër të Ministrisë dhe të Forcës, për kultivimin e një raporti shumë frytdhënës në të gjitha fushat të cilat janë të rregulluara me një memorandum bashkëpunimi në mes dy ministrive dhe dy vendeve tona. Koloneli Aydoglu u shpreh gjithashtu se bashkëpunimi në mes Republikës së Turqisë dhe Republikës së Kosovës, në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, do të vazhdojë po me këtë intensitet edhe në të ardhmen nga pasardhësi i tij.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama takoi atasheun ushtarak të Japonisë Yoshimasa Taki



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti në takim atasheun ushtarak të Japonisë të akredituar në Republikën e Kosovës, kolonelin Yoshimasa Taki, i cili kohëve të fundit është emëruar në këtë detyrë. Më këtë rast, gjeneral Rama pasi i uroi detyrën e re kolonelit Taki, ai shprehi falënderimin e tij për gjithë angazhimin dhe kontributin që ka dhënë Japonia deri me tani për Ministrinë dhe Forcën e Sigurisë. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjithashtu, tha se ne i jemi mirënjohës Qeverisë së Japonisë e cila nëpërmjet Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar pati ofruar ofertë për trajnimin e një pjesëtari në "Teknikat e shpëtimit", i cili u organizua në Tokio në vitin 2010. Gjeneral Rama u shpreh i gatshëm për bashkëpunim me kolonelin Yoshimasa Taki, e nëpërmjet tij edhe me Ministrinë e Mbrojtjes të Japonisë si dhe me Forcat e Armatosura të saj.Ndërsa, nga ana e tij, atasheu ushtarak i Japonisë, kolonel Yoshimasa Taki siguroi gjeneral Ramën se bashkëpunimi i deritanishëm në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë do të thellohet edhe më shumë në të ardhmen. Kjo ishte vizita e parë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe takimi me komandantin e FSK-së, gjeneral Rrahman Rama, që prej se koloneli Yoshimasa Taki ka marrë detyrën e atasheu ushtarak të Japonisë në Republikën e Kosovës.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

INTERVISTË ME ZËVENDËSKOMANDANTIN E KOMANDËS SË FORCAVE TOKËSORE, GJENERAL BRIGADE GËZIM HAZROLLIN

Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli përfundoi studimin njëvjeçar në "Kolegjin Mbretëror të Mbrojtjes" në Mbretërinë e Bashkuar


Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, pas kthimit nga studimi njëvjeçarë në Mbretërinë e Bashkuar, në një intervistë për gazetën "Forca Jonë".

Gazeta "Forca Jonë": *Gjeneral, tani keni përfunduar një trajnim të nivelit të lartë në Kolegjin Mbretëror në Mbretërinë e Bashkuar, çfarë mund të na thoni më shumë lidhur me këtë trajnim ?*

Gjeneral Hazrolli: Emri i kolegjit është "Kolegji Mbretëror për Studime të Mbrojtjes". Sipas nivelit të edukimit në Angli është edukimi më i lartë për ushtarak dhe diplomat, në sistemin e edukimit të tyre, është një koncept i studimit ku marrin të theksoj që është një mbështetje nga Mbretëria e Bashkuar për FSK-në, por edhe për Kosovën. Kam pas fatin me qenë i pari i sfiduar në aspektin personal, për shkak të kërkesave të larta dhe standardeve për t`u arritur, por ka qenë një privilegj pa dyshim. Unë jam munduar që brenda mundësive të mia të vendos standarde, por jam shumë i sigurt që kolegët tjerë, të cilët do ta vijojnë këtë kolegj, duhet t`i ngritin ato standarde, sepse është kërkesë e kohës që një bashkëpunim të gjatë me Mbretërinë e Bashkuar, pastaj shtetet nga Amerika e Jugut, Afrika, Azia e Largët, Lindja e Mesme, Shtetet Arabe, Evropa, Kosova, Shqipëria etj.

Gjatë studimit ne kemi pasur mundësi të jashtëzakonshme të ndërtimit të miqësive me shumë njerëz që është një mundësi e shkëmbimit të informacioneve të rëndësishme të sigurisë, të cilat janë kërcënim i sigurisë për të gjithë popujt e botës. Sipas planit kemi bërë edhe vizita jashtë Mbretërisë së Bashkuar, me karakter studimi dhe shkëmbimi përvojash, si: në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Uashington dhe New York), ku kemi vizituar institucionet më të larta të sigurisë atje, por edhe institucionet ndërkombëtare siç është OKB-





hemi me gjithë historikun e kësaj ngjarje dhe të vizitojmë memorialët e luftëtarëve që kanë rënë në këto beteja si nga India, Australia e largët, Zelanda e re, etj. Ndër udhëtimet tjera shumë interesante ka qenë një javë udhëtim në Mbretërinë e Bashkuar duke realizuar vizita në institucione shtetërore, qeveri, kompani të ndryshme të prodhimit të pajisjeve ushtarake, ku jemi njoftuar me organizimin e këtyre institucioneve dhe funksionimin e tyre.

Gazeta "Forca Jonë": *A mund të na thoni diçka më shumë për kuadrin akademik të Kolegjit?*

Gjeneral Hazrolli: Kuadri i ligjëruesve ka qenë një kuadër i jashtëzakonshëm me një përgatitje të lartë dhe karrierë të gjatë në aspektin diplomatik e të sigurisë. Ishte nderë të takohemi dhe të jemi të pranishëm në ligjëratat e tyre, duke filluar prej liderëve të ndryshëm të Mbretërisë së Bashkuar Ketrin Eshton, Paddy Eshdown, Robert Kuper e shumë të tjerë të cilët kanë një karrierë të gjatë të shërbimit në misione të ndryshme të sigurisë dhe paqes. Ligjëruesit në përgjithësi kanë qenë nga fusha dhe profesione të ndryshme por në përgjithësi kanë qenë lider të cilët janë në vendimmarrjen e shteteve të tyre ose në vendimmarrje të organizatave të ndryshme evropiane dhe botërore.

Gazeta "Forca Jonë": *Cila është këshilla e juaj për ushtarakët të cilët do ta kenë fatin t'i ndjekin studimet në këtë kolegj?*

Gjeneral Hazrolli: Sa i përket kolegëve tjerë, të cilët do të kenë fatin të shkollohen në këtë institucion, mendoj që kanë obligim të lënë një përshtypje të mirë për shkak të interesit tonë si shtet i ri, që të marrim pjesë në këto shkollime dhe institucione që janë shumë prestigjioze ku hapen mundësi të bashkëpunimit sot dhe në të ardhmen, por e veçanta është se me të vërtetë duhet të tentojmë të prezantojmë vetveten dhe të prezantojmë shtetin në mënyrën më të mirë, përparësia e gjithë kësaj është të kemi një qasje në këto institucione të edukimit të vendosim urat e bashkëpunimet me miqtë tanë të cilët po na ndihmojnë në rrugën tonë të ecjes përpara.



pjesë të gjitha institucionet e sigurisë, që janë të përfshira në ndërtimin e strategjive të sigurisë dhe të mbrojtjes në Mbretërinë e Bashkuar, ku i gjithë fokusi i studimit bëhet në temat: Përpilimi i strategjive nacionale të sigurisë dhe mbrojtjes, Analizat e strategjive dhe implementimi i tyre në praktikë. Kjo mundësi studimi nuk ofrohet shpesh për shtetet si Kosova që janë në zhvillim, për shkak të numrit të kufizuar të pjesëmarrësve. Për fat të mirë Kosovës i është ofruar kjo mundësi edhe këtë vit, dhe Kosova është duke u përfaqësuar nga gjeneral brigade Enver Cikaqi. Për mua personalisht por edhe për të gjithë pjesëmarrësit ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme, dua me të vërtetë të tentojmë të marrim sa më shumë njohuri në ndërtimin e strategjive të sigurisë dhe ato të punojmë t`i vëmë në zbatim në vendin tonë.

Gazeta "Forca Jonë": *Gjeneral, si ishte bashkëpunimi me shtetet pjesëmarrëse, dhe a keni bërë vizita studimore edhe jashtë Mbretërisë së Bashkuar?*

Gjeneral Hazrolli: Pjesëmarrja ka qenë rrethe 98 pjesëmarrës nga 52 shtete, rreth 30 për qind e pjesëmarrësve zakonisht jenë nga Mbretëria e Bashkuar, përfaqësimi i shteteve pjesëmarrëse ka qenë në bazë të miqësisë ose bashkëpunimit që ka Mbretëria e Bashkuar me këto shtete, si shtetet e Commonwelth-it, të cilat kanë ja, vizita në Lindjen e Mesme ku kemi vizituar, Egjiptin, Jordaninë dhe Izraelin, pastaj vizita në Bruksel në selinë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, këto dy institucione shumë të rëndësishme të sigurisë dhe paqes në botë. Në të gjitha vizitat që kemi bërë kemi takuar liderë e diplomat të nivelit botërorë, të cilët janë pjesë e institucioneve vendimmarrëse në organizatat e ndryshme të sigurisë në Botë. Në kohën e qëndrimit tonë në Bruksel ishte edhe 100 vjetori i Luftës së Parë Botërore me këtë rast kemi vizituar vendet ku janë zhvilluar betejat kryesore në veçanti ato në Frontin Perëndimor të Luftës së Parë Botërore, ku patëm rastin të nji-

Në "Film Sity" u mbajt ceremonia e ndërrimit të drejtorit të NLAT-it për FSK-në

Gjeneral Rrahman Rama dekoroi gjeneralin Werner Haumann

Në ambientet e bazës së KFOR-it në „Film Sity" në Prishtinë, u mbajt ceremonia e ndërrimit të drejtorit të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në (NLAT), gjeneral brigade Werner Haumann dhe gjeneral brigade Stefan Fix. Në ceremoni morën pjesë komandanti i KFOR-it gjeneral major Guglielmo Luigi Miglietta, zëvendësministrat e MFSK-së, Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Bashkim Jashari, Zymer Halimi, Gëzim Hazrolli, Njësiti Ceremonial i FSK-së, atashe ushtarakë dhe përfaqësues të NATO-s dhe KFOR-it. Një fjalë rasti në këtë ceremoni mbajti edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i cili pasi përshëndeti të pranishmit, me bindje të plotë u shpreh se misioni i drejtorit të NLAT-it, gjeneralit Haumann ka qenë i suksesshëm në të dyja rrafshet si profesional ashtu edhe personal. Më tej gjeneral Rama tha se gjenerali Werner Haumann si drejtor i NLAT-it ka pasur shansin e veçantë që të jetë pjesë e përpjekjeve dhe zhvillimit tonë. „Me këshillimet dhe ndihmën tuaj për FSK-në, ju gjeneral Haumann na ndihmuat t'i forcojmë kapacitetet duke na lehtësuar zhvillimin tonë",- deklaroi komandanti i FSK-së. Gjithashtu, gjeneral Rama tha:„Forca e Sigurisë së Kosovës dhe NLAT-i, ndajnë të njëjtat qëllime dhe objektiva, dhe se ne do të punojmë që së bashku që t'i arrijmë ato". Ai falënderoi, me këtë rast, edhe ushtarakët e të gjitha vendeve për shërbimin e tyre si këshillues dhe ekspertë, në kuadër të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s, për FSK-në. Në fund, gjenerallejtënant Rrahman Rama në emër të FSK-së, gjeneralit Haumann i ndau mirënjohje për "Shërbim Vetëmohues" si dhe e falënderoi për bashkëpunimin dhe kontributin e tij një vjeçar në FSK-së, gjatë shërbimit të tij në krye të NLAT-it. Me këtë rast, komandanti i FSK-së i shprehu mirëseardhje drejtorit të ri të NLAT-it, gjeneral brigade Stefan Linus Fix, duke u treguar i gatshëm për bashkëpunim dhe gjithashtu i bindur se edhe gjenerali Fix do ta vazhdojë rrugën e paraardhësit të tij, gjeneralit Haumann. Drejtori në largim i NLAT-it, gjeneral brigade Werner Haumann, u shpreh se ndjehet i lumtur që ka pasur rastin të punojë ngushtë me FSK-në, dhe po ashtu shprehu bindjen se FSK-ja dhe NLAT-i do të vazhdojnë këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen. Ai, falënderoi gjeneral Ramën dhe të gjithë oficerët e FSK-së për bashkëpunimin e shkëlqyer për gjatë gjithë kohës sa punuan së bashku.





Në ceremoni para të pranishmëve me nga një fjalë rasti u paraqiten edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral major Guglielmo Miglietta dhe drejtori i ri në detyrë, gjeneral brigade Stefan Fix. Gjeneral Werner Haumann në fjalën e tij, ndër te tjera tha: "Ka qen një nder dhe kënaqësi të shërbej me familjen e KFOR-it në mbështetje të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kemi arritur bukur shumë, por ende mbetet për të bërë, me qëllim të rritjes së mëtejme në ndërtimin dhe trajnimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës". Në fund drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Werner Haumann i dorëzoj flamurin pasardhësit të tij në këtë detyrë, gjeneral brigade Stefan Fix. Në ceremoninë e ndërrimit të drejtuesve të NLAT-it, krah për krah me ushtarakët ndërkombëtarë, në shenjë nderimi ishte e pranishme edhe Njësia Ceremoniale e FSK-së.



Oficerë nga Komanda e Forcave të Bashkuara në Napoli vizitojnë FSK-në

Një delegacion i oficerëve nga Komanda e Forcave të Bashkuara në Napoli-Itali, të prirë nga rreshter majori i Komandës Manfred Jerabek vizitoi Ministrinë e FSK-së dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), ku u pritën nga gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione. Në pritje merrnin pjesë edhe oficerë të lartë të KFOR-it, NLAT-it dhe të FSK-së. Në emër të FSK-së, gjenerali Zymer Halimi shprehi falënderimin për angazhimin e rreshter majorit Jerabek për shërbimin e tij, në Komandën e Forcave të Bashkuara në Napoli, si dhe për forcat e NATO-s në përgjithësi. Ndërsa, Manfred Jerabek çmoi shumë lartë bashkëpunimin 4 vjeçar me FSK-në, dhe u shpreh i bindur se edhe zëvendësi i tij do të kontribuojë shumë në këtë drejtim. Delegacioni nga Napoli, përmes një prezantimi, u njoftua nga rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj, me të arriturat e FSK-së dhe të arriturat e zhvillimit të Trupës së Nënoficerëve. Pas prezantimit dy delegacionet diskutuan rreth avancimit të trupës së nënoficerëve dhe bashkëpunimit të mëtejmë edhe në të ardhmen.

Batalioni i Tretë i BRSH-së përfundoi ushtrimin fushor "Veprim i Shpejtë 05"



Në kuadër të gjenerimit të forcës së Batalionit të Tretë, Kompania 3A ka realizuar trajnimin katër mujor, që nga 04 maj 2015 deri më 28 gusht 2015, trajnim ky i cili është përmbyllur me ushtrimin fushor "Veprimi i Shpejtë 05". Pjesëtarët e Kompanisë 3A, gjatë këtij ushtrimi, dëshmuan se janë të përgatitur në mënyrë profesionale për operacione ushtarake siç janë patrullimet, operacionet ofensivë, defensivë, rikonicion të terrenit, pika të kontrollit, operacionet urbane dhe fusha tjera. Fokusi kryesor gjatë trajnimit ka qenë ngritja dhe profesionalizmi i pjesëtarëve të Batalionit të 3-të për kryerjen e detyrave taktike për realizimin sa më mirë të misionit të tanishëm dhe atë të ardhshëm. Për të përcjellë nga afër këtë ushtrim i pranishëm ishin Shefi i Departamentit të G3/7 i Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Bashkim Shillova, ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci si dhe zv. Komandanti i Batalionit të II-të të BRSH-së, major Valdet Berisha. Me këtë rast Kolonel Geci i përgëzoi pjesëtarët e Batalionit për angazhimin, motivimin dhe profesionalizmin e treguar, dhe njëherësh kërkoi që të vazhdohen aktivitetet me trajnime edhe më specifike në të gjitha fushat e mundshme. Gjatë këtij ushtrimi, ku ishin simuluar situata të ndryshme që ngjasonin me situata reale dhe tejet sfiduese, pjesëtarët e këtij batalioni treguan vendosmëri dhe moral të lartë për realizimin e misionit të tyre.

Në FSK u mbajt trajnimi "Zhvillimi i Specifikave Teknike dhe Hulumtimi i Tregut"

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, më 14 gusht u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve në trajnimin "Zhvillimi i Specifikave Teknike dhe Hulumtimi i Tregut". Edhe ky trajnim u realizua në bazë të planit dypalësh që ka FSK-ja me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Ligjëratat i mbajtën ekspertë nga fusha e Logjistikës, (ekipi i KFOR-it amerikan, në Bonstell), nga data 10-14 gusht 2015, e ku morën pjesë 23 veta përfaqësues të Ministrisë dhe FSK-së. Me këtë rast, gjenerali Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, falënderoi instruktorët amerikanë, ekipin e NLAT, NAT-it, për angazhimin dhe ndihmën e pakursyer që po japin në mbajtjen e trajnimeve për FSK-në, me qëllim të ngritjes profesionale sipas standardeve më të larta. "Ky trajnim është shumë me rëndësi për ne, për të ardhmen, që të ecim në hap me kohën. Ky është vetëm fillimi i trajnimeve, dhe ne do të vazhdojmë edhe në të ardhmen me trajnime të tilla, dhe të nivelit më të lartë, me qëllim të përgatitjeve sipas standardeve më të larta", tha në fund gjeneral Halimi. Ndërsa, drejtori i NAT-it, gjenerali Werner Naumann, tha se ky trajnim është me rëndësi për FSK-në, andaj e shoh këtë trajnim si një hap të rëndësishëm për të ecur përpara. Qëllimi i mbajtjes së këtij trajnimi ishte përgatitja sa më e lartë e pjesëtarëve të FSK-së, për arritjen e standardeve më të kërkuara të NATO-s, në këtë drejtim.

Në trajnim morën pjesë 23 pjesëtarë nga stafi civil i Ministrisë së FSK-së dhe stafit ushtarak i FSK-së, niveli oficerë-nënoficerë. Instruktorët amerikanë dhe trajnuesit u shprehën mjaft të kënaqur me përfundimin me sukses të këtij trajnimit.

Me këtë rast, u tha se pjesëtarët e FSK-së gjatë tërë trajnimit ishin të përkushtuar në nxënien e njohurive të reja, me qëllim të arritjeve të standardeve sa më larta në zhvillimin e specifikave teknike dhe hulumtimit të tregut. Në ceremoni morën pjesë: Gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, drejtori i NAT-it, gjeneral brigade Werner Haumann, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it amerikan.



FORCA JONË

Intervistë me nënkolonel Hasan Hoxha shef i sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në MFSK

Nënkolonel Hasan Hoxha kreu Kolegjin e Luftës të Ushtrisë Kroate në Zagreb

Nënkolonel Hasan Hoxha ditë më parë ka diplomuar në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë Kroate në Zagreb, duke e mbrojtur me sukses temën: "Siguria regjionale dhe Republika e Kosovës", e që është vlerësuar me notë të lartë.



Gazeta "Forca Jonë": *Nënkolonel Hoxha, çka mund të na thoni për nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar të FSK-së?*

Nënkolonel Hasan Hoxha: Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës i kushton rëndësi të veçantë bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes në nivelin bilateral, multilateral dhe rajonal. Nisur nga aspiratat për anëtarësim në NATO dhe BE, bashkëpunimi me vendet anëtare të këtyre dy organizatave në fushën e Mbrojtjes është prioritet, me synim që Republika e Kosovës të jetë pjesë e sistemit të sigurisë kolektive të NATO-s, duke qenë përfituese dhe kontribuuese në këtë fushë. Në nivel bilateral kemi nënshkruar memorandume bashkëpunimi me këto shtete: Britaninë e Madhe, Lituanin, Holandën, Turqinë, Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Kroacinë, Letoninë, Gjermaninë dhe Sllovenинë, dhe jemi në proces për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me Republikën e Italisë dhe Hungarinë. Gjithashtu përmes Programit të Partneritetit Shtetëror me Ajovën është thelluar edhe më tej bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes me SHBA-të, që janë kontribuuesi më i madh në asistimin e FSK-së në fushën e shkollimit dhe trajnimit të pjesëtarëve si dhe asistencës nëpërmjet programeve të tjera. Çdo vit MFSK harmonizon dhe nënshkruan "Planet Bilaterale" për shkollimet, trajnimet, shkëmbimin e përvojave në fusha të ndryshme dhe aktivitete të cilat kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve ushtarake të FSK-së. Ne, në këtë drejtim, kemi edhe një bashkëpunim të mirë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Kroacisë, ku nga ky program kanë përfituar edhe 2 oficerë të FSK-së, në shkollim në Kolegjin e Luftës të Kroacisë si dhe pjesëtarë të tjerë në trajnime të ndryshme.

Gazeta "Forca Jonë": *Nënkolonel Hoxha, sa është duke i kushtuar rëndësi FSK-ja shkollimit dhe përgatitjeve të kuadrove jashtë vendit?*

Nënkolonel Hasan Hoxha: Siç u tha më lartë, MFSK-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me 11 shtete, dhe çdo vit akademik ne dërgojmë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë për shkollim nga të gjitha nivelet. Gjithashtu, kemi filluar shkollimin e kuadrove tona edhe në shkollat e NATO-s. Vlen të theksohet se trajnime të nivelit të lartë zhvillohen në SHBA, Britani të Madhe, Turqi, Gjermani, Kroaci, Shqipëri si dhe vende të tjera. Përderisa ne synojmë të integrohemi në strukturat euro-atlantike, fokusimi ynë është në ngritjen e kapaciteteve sipas standardeve të NATO-s.

Gazeta "Forca Jonë": *Ju sapo jeni kthyer nga shkollimi njëvjeçar në Kroaci, cili ishte niveli studiues i Kolegjit të Ushtrisë Kroate?*

Nënkolonel Hasan Hoxha: Kolegji i Luftës është pjesë e shkollimit të Akademisë së Mbrojtjes të Kroacisë i themeluar në vitin 1998 me vendim të Presidentit të Republikës së Kroacisë dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e që është shkollimi më i lartë ushtarak në Republikën e Kroacisë. Qëllimi është trajnimi i oficerëve të cilët duhet të merren me detyra të niveleve të larta në lëmine e Sigurisë Nacionale dhe të Mbrojtjes.

Në Akademinë e Mbrojtjes të Kroacisë, përveç oficerëve të saj, (8 oficerë), merrnin pjesë edhe përfaqësues të Gjermanisë, Maqedonisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kosovës.

Gazeta "Forca Jonë": *Ky, sigurisht, ka qenë një program shumë i ngjeshur, sa keni arritur t'i përshtateni natyrës së punës gjatë shkollimit në Zagreb?*

Nënkolonel Hasan Hoxha: Shkollimi në këtë kolegj zgjatë një vit akademik dhe përfaqëson nivelin strategjik të shkollimit civilo-ushtarak. Kriteret për shkollim në Kolegjin e Luftës janë shumë të larta duke pasur parasysh se ky kolegj është një prej kritereve për t'u avancuar në gradat më të larta ushtarake, dhe atë edhe në gradën e gjeneralit. Natyrisht që programi në Kolegjin e





Luftës ka qenë tejet i ngjeshur, më tema të ndryshme në aspektin strategjik. Aspekti teorik dhe praktik është koordinuar në mënyrën më të mirë të mundshme e po ashtu edhe debatet e shumta gjatë procesit mësimor, përvojat e ndryshme të oficerëve kroat e po ashtu edhe oficerëve të vendeve tjera pjesëmarrëse në këtë kolegj kanë bërë që gjenerata e 17 e Kolegjit të Luftës të jetë njëra ndër gjeneratat më të suksesshme të këtij shkollimi në të gjitha aspektet.

Gazeta "Forca Jonë": *Nënkolonel Hoxha, cilat ishin fushat kryesore të shkollimit tuaj?*

Nënkolonel Hasan Hoxha: Gjatë shkollimit në kolegj janë trajtuar katër fusha të studimit: Siguria, Menaxhimi i mbrojtjes, Strategjia ushtarake kombëtare, Strategjia dhe shkathtësitë luftarake. Përveç fushave kryesore që i përmenda, subjekt i studimit kanë qenë edhe fusha të tjera si: Metodologjia e kërkimeve shkencore dhe profesionale, Arti i komunikimit dhe sistemet e informacionit. Ligjërues në kolegj ishin figura të larta të shtetit kroat, zyrtarë civilë dhe ushtarakë nga Kroacia si dhe ekspertë të huaj të fushave të ndryshme. Këshilli mësimor i Kolegjit të Luftës ishte i përbërë nga përfaqësuesit e Akademisë Kroate të Mbrojtjes i cili menaxhon procesin arsimor.

Gazeta "Forca Jonë": *Nënkolonel Hoxha, ju keni diplomuar me sukses në Kolegjin e Luftës me temën "Siguria regjionale dhe Republika e Kosovës", a mund të na thoni diçka më shumë?*

Nënkolonel Hasan Hoxha: Në punimin e diplomës kam paraqitur rolin e pranisë së bashkësisë ndërkombëtare në procesin e ndërtimit të institucioneve në Kosovë. Temën e kam ndarë në katër kapituj. Kapitulli i parë përshkruan statusin e Kosovës në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, në veçanti marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe shteteve në rajon. Në kapitullin e dytë jam përqendruar në stabilitetin ekonomik të Kosovës. Ndërsa në pjesën e tretë të punimit kam paraqitur tërë kontekstin e sektorit të sigurisë në Kosovë, duke filluar nga viti 1999 deri në procesin e fundit të zhvillimit në lidhje me krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Në kapitullin e fundit në fokus kisha sigurinë dhe procesin e integrimit euro-atlantik. Po ashtu kam paraqitur perceptimin publik të organizatave dhe aktorëve ndërkombëtarë në Kosovë, në bazë të sondazheve të opinionit të cilat janë të realizuara nga organizata në Kosovë.

Gazeta "Forca Jonë": *Sa do të mundeni t'i praktikoni këto njohuri në Forcat e Armatosura të Kosovës?*

Nënkolonel Hasan Hoxha: Gjatë kësaj përudhe të shkollimit në Akademinë e Mbrojtjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, kemi përforcuar njohurit por gjithashtu edhe kemi përfituar njohuri të reja në lëmit të cilat i përmenda më lartë. Njohuritë e fituara në Kolegjin e Luftës do t'i shfrytëzojmë në mënyrën më të mirë të mundshme me qellim që ekspertizën e fituar ta përdorim për të ngritur kapacitetet në nivelin më të lartë edhe në të ardhmen në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Gazeta "Forca Jonë": *Në fund, cili është mesazhi i juaj për pjesëtarët e FSK-së që studiojnë jashtë Kosovës?*

Nënkolonel Hasan Hoxha: Shkollimet dhe trajnimet e niveleve të ndryshme të cilat po na i ofrojnë shtetet me të cilat kemi marrëdhënie bashkëpunimi janë të mirëseardhura për të ngritur profesionalizimin e nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së. Unë kërkoj nga të gjithë pjesëtarët e FSK-së, që shkollohen në këto Kolegje, Akademi apo shkolla ushtarake ta shfrytëzojnë kohën në maksimum me qëllim të përfitimit të përvojave të tyre, në të gjitha fushat, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të mirëfillta në të ardhmen të institucionit tonë, si nder institucionet me të besueshme të shtetit të Kosovës.

Deminerët me përkushtim vazhdojnë pastrimin e territoreve të minuara nga mjetet e pashpërthyera

Gjatë këtij viti kalendarik, deminerët e FSK-së, kanë hulumtuar mbi 175.519 metra katrorë në pesë vende në Kosovë, dhe kanë shkatërruar mbi 208 mjete eksplozive të pashpërthyera.



Që nga fillimi, prej vitit 2010, njësitet e dominimit të FSK-së kanë pastruar 17 lokacione të ndryshme dhe kanë hulumtuar mbi 1,371,271 metra katrorë dhe kanë gjetur mbi 1861 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera. Gjatë këtij viti, po vazhdon pastrimi i zonave në kazermën e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe në Parkun e Lirisë në Ferizaj, në fshatin Gorancë-Hani i Elezit, në Luzhnicë- Komuna e Suharekës, në Zagrimle - Komuna e Pejës etj. Një tog i EOD-së, kryen vazhdimisht shërbime kujdestarie çdo 24 orë.Këtë vit, deminerët kanë pastruar mbi 175,519 metra katrorë të territorit të minuar dhe kanë gjetur dhe shkatërruar mbi 208 predha të llojeve të ndryshme eksplozive të pashpërthyera, si: projektil, granata dore, mortaja, raketa, bomba-kasetë, mina të ndryshme etj.Ekipet e EOD-së, në përgjigje të thirrjeve gjatë kujdestarisë, kanë intervenuar në 1661 raste thirrje të qytetarëve dhe kanë shkatërruar mbi 2600 mjete të pashpërthyera të llojeve të ndryshme.Të udhëheqësh Kompaninë e Deminimit është privilegj, por në të njëjtën kohë është edhe përgjegjësi e madhe me rrezikshmëri për pjesëtarët e deminimit, mirëpo falë profesionalizmit të tyre, gjatë punës që po e bëjnë me përkushtim, kanë arritur që të pastrojnë një sipërfaqe të madhe të zonave të rrezikshme, kanë gjetur shumë mjete të pashpërthyera dhe nuk ju ka ndodhur asnjë incident. Ky përkushtim i tyre na bënë të gjithëve të ndihemi krenarë për ta, na thotë komandanti i saj, kapiten Sejdi Krasniqi i cili shton, se:" Kompania e Deminimit funksionon si një kolektiv i përgjithshëm ku të gjitha aktivitetet janë të harmonizuara sipas zinxhirit komandues. Kujdes i veçantë po i kushtohet edhe ngritjes profesionale të pjesëtarëve të kompanisë. Mjetet të cilat përdoren gjatë kryerjes së operacioneve të deminimit janë të përshtatshme dhe janë në gjendje të mirë. Ekipet e deminimit të FSK-së, janë të trajnuar për zhvillimin e operacioneve për deminim humanitar sipas standardeve ndërkombëtare për deminim si dhe EOD-së. Kompania e Deminimit është në gjendje të demoloj të gjitha minat dhe municionet konvencionale, përveç mjeteve të improvizuara eksplozive, biologjike, kimike dhe armëve nukleare. Kompania e Deminimit po përkrahet, me donacione, nga Departamenti i SHBA-ve, me pajisje për deminim, pajisje për trajnim, pajisje medicine, si dhe mjete për mirëmbajtjen e pajisjeve të deminimit si dhe me kurse për mirëmbajtjen e tyre. Po ashtu Kompania ka bashkëpunim të ngushte me KFOR amerikan ku së bashku kanë zhvilluar trajnime të ndryshme në demolimin e mjeteve të gjetura. Ekipet e deminimit edhe gjatë këtyre ditëve me vapë, po vazhdojnë pastrimin e fushave të minuara në Kosovë.

Gjeneral Cikaqi në mesin e studentëve më të mirë në Institutin e Gjuhëve në Teksas



Instituti i Mbrojtjes së Gjuhëve në Teksas të SHBA-ve e ka zgjedhur gjeneralin e FSK-së, Enver Cikaqin, në mesin e tetë studentëve më të mirë në dhjetë vjetët e fundit të studimeve. Ky është edhe një sukses i FSK-së, e që dëshmon se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) po i kushton rëndësi të madhe shkollimit të pjesëtarëve të saj, përmes trajnimeve në qendrat më të mëdha botërore, me qëllim të ngritjes në aspektin profesional dhe të udhëheqjes. Ky është edhe sukses i vetë gjeneral Cikaqit, kur dihet se në këtë Institut me famë studiojnë me qindra studentë-ushtarakë nga mbarë bota. Në Hollin e Institutit, që njëherësh quhet "Muri i Famës" fotografia e gjeneral Enver Cikaqit është e renditur e gjashta. Gjeneral brigade Enver Cikaqi është komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj. Studimet në Institutin e Mbrojtjes të Gjuhëve në Teksas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës i ka kryer në vitin 2010, ku ka treguar rezultate të larta gjatë studimeve.Ceremonia e përzgjedhjes së tetë studentëve më të mirë u mbajt më 21 gusht 2015, ku u bë përzgjedhja e studentëve të dalluar gjatë studimeve dhe të cilët kanë krijuar karrierë të suksesshme, e që kanë qenë pjesë e studimeve të këtij Institucioni. Fotot e vendosura në "Murin e Famës" mbesin pjesë e historisë së Shkollës. Institutin e Mbrojtjes së Gjuhëve e kanë kryer me sukses edhe dhjetëra oficerë e nënoficerë të FSK-së, që nga viti 1999 e deri më sot.Vlerësimi që i është bërë komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) gjeneral brigade Enver Cikaqi nga ky Institut është nder për vetë Forcën e Sigurisë së Kosovës, Kosovën dhe Gjeneral Cikaqin. Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi ka fituar të drejtën e shkollimit, për një vit, edhe në Kolegjin Mbretëror të Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, që është një ndër Kolegjet me Famë Botërore, nga ky Kolegj, kanë dalë gjeneral dhe udhëheqës të njohur të shumë shteteve. Gjenerali Enver Cikaqi po i ndjek studimet në programin e Mbrojtjes në Kolegjin e Mbrojtjes në Londër.

FSK-ja dhuroi mbi 400 doza gjak

Për dhjetë ditë, sa ka zgjatur aksioni humanitar vullnetar për dhurimin e gjakut, në MFSK dhe në njësitet tjera të FSK-së, edhe përkundër pushimeve vjetore, janë grumbulluar 407 doza gjak, për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, që do të jenë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës të cilët kanë nevojë për të. Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës ka përfunduar aksioni humanitar i dhurimit vullnetar të gjakut, me moton: "Një pikë gjak, për shpëtimin e një jete", në organizim të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, dhe Departamentit të Mjekësisë të MFSK-së, Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës dhe të Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së. Me fillimin e aksionit humanitar të dhurimit të gjakut, ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli i përgëzoi të gjithë pjesëtarët dhurues vullnetar të gjakut për gatishmërinë e tyre, që t'i përgjigjen këtij aksioni humanitar, si dhe personelin mjekësor të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK) dhe të Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së, për angazhimin dhe punën e palodhshme.

Aksioni humanitar i dhurimit vullnetar të gjakut ka filluar më 3 gusht në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, dhe për dhjetë ditë ka vazhduar në të gjitha njësitet e FSK-së ku janë dhuruar mbi 407 doza gjak.Ministria dhe FSK-ja kanë një traditë të organizimit dhe të dhurimit humanitar të gjakut, dhe se ky është aksioni i dytë brenda këtij vitit. Në aksionin e janarit pjesëtarët e FSK-së dhe shërbyesit civilë në Ministri dhe Forcë dhuruan mbi 300 doza gjak. Pra brenda vitit 2015, në të dyja aksionet janë dhuruar gjithsejtë mbi 700 doza të gjakut, për nevoja të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës. Ndërsa, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në MFSK, z. Harjush Kurtaj, tha se: "Pjesëtarët e FSK-së jo vetëm gjatë organizimit të aksioneve të rregullta, siç ishte edhe ai në fillim të këtij viti, më 20-30 janar 2015, dhe ky tani, por ata po dhurojnë gjak edhe jashtë këtyre organizimeve, sa herë qe



është e nevojshme. Andaj me të drejtë mund të themi se FSK-ja është donator i rregullt i dhurimit të gjakut dhe se pjesëtarët e saj çdo herë i janë përgjigjur me vullnet këtij aksioni".

Koncert i përbashkët i Trupës muzikore të FSK-së dhe Trupës muzikore të KFOR-it gjerman

Bendi muzikor i FSK-së së bashku me Bendin muzikor të KFOR-it gjerman, në amfiteatrin e qytetit në Prizren, më 21 gusht 2015, dhanë një koncert të përbashkët, para stafit më të lartë të FSK-së, KFOR-it, si dhe të qytetarëve të Prizrenit. Në koncertin e organizuar nga FSK-ja dhe KFOR-it gjerman, mori pjesë komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me stafin më të lartë të FSK-së, gjenerali gjerman Werner Haumann dhe stafi më i lartë i KFOR-it gjerman dhe atij turk, kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Ramadamn Muja dhe oficerë të FSK-së dhe KFOR-it, si dhe shumë qytetarë. Interpretimet e dy bendeve muzikore u mirëpritën nga pjesëmarrësit me duartrokitje. Bendi muzikor i FSK-së, ka bashkëpunim të mirë edhe me bendet ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar dhe të Shqipërisë, ku kanë dhanë koncerte të përbashkëta në ngjarje të rëndësishme.

Ky koncert u organizua për nder të drejtorit të NLAT-it, (Ekipit Këshillues të NATO-s për FSK-në), gjeneral brigade Werner Haumann, i cili ditë më parë ka përfunduar detyrën e tij në Kosovë.



30 pjesëtarë të FSK-së certifikohen në fushën e sigurisë



Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, më 28 gusht u mbajt ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës, të cilët përfunduan trajnimin "Sigurimi fizik, sigurimi i informacionit të klasifikuar dhe mbrojtja e Forcës". Edhe ky trajnim ishte në vazhdën e trajnimeve dypalëshe me SHBA-të, dhe u realizua nga një ekip i instruktorëve nga USAEUR-i, në fushën e inteligjencës, nga data 24-28. 08. 2015. Në ceremoninë e certifikimit, ishin të pranishëm gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i G2 të KFT-së, nënkolonel Ilir Shyti etj. Me këtë rast, gjeneral Halimi falënderoi ODC-në, si dhe Ushtrinë Amerikane, të cilët janë duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe në ngritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në nivel sa më të lartë. Gjeneral Halimi falënderoi edhe ekipin e instruktorëve për punën dhe vullnetin e treguar gjatë këtij trajnimi, si dhe foli për rëndësinë që ka ky trajnimi për FSK-në. "Ne kemi nevojë për bashkëpunimin dhe eksperiencën tuaj, në këtë fushë mjaft të rëndësishme për zhvillimin e forcave tona dhe shpresoj që edhe në të ardhëm do të vazhdojmë të kemi një bashkëpunim si deri më tani". Ndërsa, instruktori amerikan, kapteri i parë, Erik Aderson u shpreh mjaft i kënaqur me të arriturat e këtij trajnimi "pas pesë ditësh trajnimi dhe diskutimi mund të them, se ja vlen që të vazhdojmë trajnimin me disa prej jush, për disa javë, apo edhe muaj, pasi është shumë e dobishme të punojmë se bashku për një kohë". Gjeneral Halimi, në shenjë respekti për punën dhe angazhimin, instruktorëve iu dha mirënjohje, ndërsa pjesëmarrësve certifikata.

Formohet klubi i futbollisteve të FSK-së

Në kuadër të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), këtë vit u formua edhe klubi i futbollisteve. Më 30 korrik 2015, në stadiumin e kazermës së FSK-së në Gjilan, u zhvillua ndeshja e parë zyrtare në mes përfaqësueseve të KF FSK-së dhe KF " Drita" nga Gjilani, e cila garon në Ligën e Kosovës. Meritat më të mëdha për formimin e këtij klubi futbolli i takojnë togere Mimoza Budecit, pjesëtare e Batalionit të Brigadës për Reagimit të Shpejtë. Togere Budeci lidhur me këtë nder të tjera tha: "Është vërtetë e rëndësishme për gratë që të kenë mundësi për të përfaqësuar FSK-në, në të gjitha sportet, pse jo edhe në futboll". Ekipin e futbollit të FSK-së e ka ndihmuar edhe David Jones, këshilltar i komandantit të FSK-së, duke ua siguruar veshjet sportive të dhuruara nga Shoqata e Futbollit të Ushtrisë Britanike.

Loja në mes ekipit të FSK-së dhe "Dritës" përfundoi me rezultat 7:3 në të mirë të Dritës. Kjo megjithatë nuk e zvogëloi paraqitjen e mirë të ekipit të femrave të FSK-së, pasi që ky ishte takimi i tyre i parë.



40 pjesëtarë të FSK-së mësojnë teknikat e notit

Në kuadër të shumë aktiviteteve që organizohen në Forcën e Sigurisë së Kosovës, gjatë muajit gusht, në Pishinën e Gërmisë në Prishtinë u mbajt edhe trajnimi në mësimin e teknikave të notit. Në këtë trajnim morën pjesë 40 pjesëtarë të Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së. Qëllimi i këtij trajnimi



ishte që pjesëtarët e FSK-së të përfitojnë sa më shumë njohuri rreth teknikave të notit, si: krol, krol në shpinë, bretkosë dhe delfin,- na thotë instruktori i notit, major Liman Salihu. Interesimi i pjesëtarëve të FSK-së, për mësimin e teknikave të notit, ka qenë i madh dhe ushtrimet kanë sjellë rezultate të mira. Ky trajnim është realizuar çdo ditë pune që nga data 4 deri më 14 gusht 2015. Ne edhe në të ardhmen do të vazhdojmë me organizimin e trajnimeve të tilla, me qëllim që të përfitimit të njohurive të notit të gjithë pjesëtarët e FSK-së, shton major Salihu. Trajnimi u vlerësua mjaft i suksesshëm.

FORCA JONË

* * * Viti IV • Nr. 39 • TETOR 2015 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri Haki Demolli në Samitin e Mbrojtjes në Bruksel

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli, u nis sot për në Bruksel ku do të marrë pjesë në punimet e Samitit të II-të Evropian të Mbrojtjes, që do të zhvillojë punimet më 16 dhe 17 shtator, organizuar nga konferenca për Siguri e Mynihut.

Ministri Demolli është ftuar që të jetë pjesë e konferencës në mesin e 200 vendimmarrësve nga politika, forcat e armatosura dhe komuniteti i biznesit, të cilët do të mblidhen në kryeqytetin e



Evropës për të diskutuar të ardhmen e mbrojtjes evropiane kundër shfaqjes së krizave në Evropë dhe përreth saj. Ambasadori Wolfgang Ischinger do të kryesojë punimet e konferencës në të cilën do të trajtohet edhe çështja se ku qëndrojnë politikat e mbrojtjes dhe të sigurisë, në dritën e konfliktit në Ukrainë, luftën në Siri dhe gjithashtu krizën e refugjatëve dhe sfida të tjera. Në Bruksel do të analizohet edhe gjendja aktuale lidhur me zbatimin e vendimeve të rëndësishme ekzistuese të NATO-s dhe BE-së, iniciativat e domosdoshme për arritjen e synimeve në integrimet ekonomike dhe ushtarak në sektorin e mbrojtjes, si dhe çështje të tjera mbi mundësitë e ri-definimit të prioriteteve strategjike të Evropës. Ministri i Demolli në Samitin Evropian të Mbrojtjes është shoqëruar nga këshilltari i tij ushtarak, kolonel Fadil Hadergjonaj dhe atasheu ushtarak i FSK-së i akreditуar për vendet e Beneluksit, nënkolonel Ahmet Ajeti.

Ministri i FSK-së, Demolli priti ministren e Mbrojtjes së Sllovenisë, znj. Katiq

Në ambientet e Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës për vizitë qëndroi ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Sllovenisë, znj. Andreja Katiq, e cila u prit nga ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli. Ministri Demolli pasi i dëshiroi mirëseardhje ministres së Mbrojtjes së Sllovenisë znj. Katiq e falënderoi Qeverinë e Sllovenisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes për ndihmën e tyre që ata kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin për FSK-në, si përmes këshilltarëve në NAT dhe NLAT, ashtu edhe përmes pjesëmarrjes së FSK-së në ushtrimet rajonale në Sllloveni. Ai po ashtu e njoftoi ministren Katiq me zhvillimet e përgjithshme në MFSK, si në fushën e arsimimit, trajnimeve, bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe me procesin transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës. Po ashtu, Ministri Demolli kërkoi nga ministrja e Mbrojtjes së Sllovenisë përkrahjen e saj për pjesëmarrjen e FSK-së në nismat regjionale dhe integrimet euro-atlantike. Ministrja e Mbrojtjes së Sllovenisë, nga ana e saj, theksoi se jemi të kënaqur me nivelin e bashkëpunimit në mes të dy ministrive, përkatësisht FSK-së dhe Ushtrisë së Sllovenisë, dhe ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen në fushat me interes të përbashkët. Në takim ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministrat Fadil Gashi e Muhamet Latifi dhe këshilltari i ministrit për çështje ushtarake, kolonel Fadil Hadërgjonaj, ndërsa pjesë e delegacionit slloven ishin edhe ambasadori i Sllovenisë në Kosovë, z. Miljan Majhen, Petra Culetto, zyrtar nga Zyra e Ministrit dhe Leon Recnik nga Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes.



Ministri i FSK-së, Haki Demolli, takoi ambasadorin e ri të SHBA-ve në Kosovë

Ministri i FSK-së, zoti Haki Demolli, priti ambasadorin e ri të SHBA-ve në Kosovë Greg Delawie. Ministri Demolli pasi e uroi ambasadorin për detyrën e re e njoftoi edhe me zhvillimet e reja në MFSK, duke nënvizuar procesin e transformimit të FSK-së, përgatitjet që janë bërë deri më tani dhe procedurat nëpër të cilat duhet të kalojë ky proces, gjegjësisht sfidat me të cilat do të ballafaqohet. Po ashtu ministri Demolli foli edhe për shkallën dhe dinamikën e bashkëpunimit në mes të MFSK-së përkatësisht FSK-së me ushtrinë e SHBA-ve, donacionet e shumta që janë dhënë nga SHBA-të, trajnimet e ndryshme duke theksuar partneritetin e shkëlqyeshëm që ekziston në bashkëpunim mes Gardës Kombëtare të Ajovës dhe FSK-së. Ministri Demolli shprehi bindjen se gjatë mandatit të ambasadorit Delawie ky bashkëpunim do zgjerohet dhe thellohet edhe më tutje. Nga ana e tij ambasadori Delawie shprehi kënaqësinë për nivelin e bashkëpunimit të deritashëm në mes dy shteteve, sidomos në mes Departamentit të Mbrojtjes dhe MFSK-së, ushtrisë së SHBA-ve dhe FSK-së, duke vlerësuar arritjet e FSK-së dhe punën e mirë që është bërë deri më tash në fushat përkatëse duke treguar një kujdese të posaçëm për integrimin e minoriteteve. Me këtë rast ambasadori Delawie u shpreh se ky bashkëpunim do vazhdojë edhe në të ardhmen. Ambasadori Delawie theksoi se siguria rajonale është njëra nga prioritetet dhe lavdëroi përkushtimin e FSK-së për t'u stërvitur me ushtrinë amerikane dhe aleatët tjerë. Në takim morën pjesë komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, shefi i kabinetit të ministrit Xhevdet Halili, Michel Polyak-shef i Politikave Ushtarake në Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë dhe Anthony Butts-atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë.



Ministri i FSK-së, Haki Demolli, priti komandantin e ri të KFOR-it

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z.Haki Demolli, priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneral major Guglielmo Luigi Miglietta me bashkëpunëtorë, në vizitën e tij të parë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës prej që ka ardhur në këtë detyrë. Gjatë takimit, në të cilin morën pjesë edhe zëvendësministri Muhamet Latifi, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe këshilltari ushtarak i ministrit kolonel Fadil Hadergjonaj, është biseduar për aspektet e sigurisë në Kosovë si dhe rreth çështjeve të bashkëpunimit dhe koordinimit në të mirë të sigurisë dhe stabilitetit në vend. Ministri Demolli i ka shprehu komandantit të KFOR-it mirënjohjen për punën dhe angazhimin e KFOR-it në Kosovë në të mirë të paqes, konsideratën e tij të lartë për KFOR-in në këtë drejtim, si dhe gatishmërinë e drejtuesve të tij për bashkëpunim me Ministrinë dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës me bindjen që edhe gjeneral Luigi Miglietta do ta vazhdojë dhe thellojë edhe më tutje këtë bashkëpunim të frytshëm që është kultivuar deri më tani. Ndër të tjera, Demolli përmendi bashkëpunimin e mirë të Ministrisë dhe FSK-së me KFOR-in më rastin e realizimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit në lumin Ibër, pastaj ndërtimin e urës në Lumbardh tek Manastiri i Deçanit si dhe projekte tjera në të mirë të qytetarëve. Gjeneral Miglietta në takim me krerët e FSK-së tha se atë e gëzon fakti se siguria në Kosovë dhe bashkëpunimi i KFOR-it me institucionet e sigurisë në vend është në nivel, dhe se kjo është një garanci për një ambient të qetë dhe të sigurt. Kjo ishte vizita e parë e gjeneralmajor Migliettas në MFSK prej se është emëruar komandanti i KFOR-it në Kosovë.



Gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në konferencën SHBA-Karta e Adriatikut në Ohër

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, po merr pjesë në konferencën SHBA-Karta e Adriatikut (A-5), të shefave të Mbrojtjes të shteteve të Rajonit dhe të Komandës Amerikane në Evropë (USEUCOM), e cila po mbahet në Ohër të Maqedonisë. Qëllimi i kësaj konference është bashkëpunimi rajonal për ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme nëpërmjet mbështetjes së stërvitjeve dhe operacioneve të përbashkëta, partneritetit me NATO-n dhe arritja e caqeve të aftësive profesionale.



Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij të mbajtur në këtë konferencë, shprehi gatishmërinë e Kosovës për pjesëmarrje në të gjitha iniciativat rajonale dhe për angazhim të vazhdueshëm për anëtarësim në NATO. Ai po ashtu shfaqi gatishmërinë për pjesëmarrje në operacione ndërkombëtare dhe rajonale me kapacitetet që ka FSK-ja. Komandanti i FSK-së në këtë konferencë shoqërohej nga komandanti i Gardës Kombëtare të Aiovës, gjenerali Timothy Orr. Pjesëmarrës në këtë konferencë janë: shefat e mbrojtjes të shteteve të rajonit, admirali amerikan Ferguson, nga Komanda Amerikane për Evropë (USEUCOM), komandantët e gardave kombëtare të Shteteve Federale të SHBA-ve, e që janë partnere me vendet e rajonit. Konferenca pritet t'i përmbyll punimet nesër.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, priti ambasadorin e Italisë Andreas Ferrarese

Ministri Haki Demolli priti sot ambasadorin e Italisë në Kosovë z. Andreas Ferrarese, të cilin e falënderoi për ndihmën që Qeveria e Italisë po jep për Kosovën dhe FSK-në. Ai njëherësh e njoftoi ambasadorin edhe me zhvillimet e përgjithshme në MFSK dhe FSK, me theks të veçantë me zhvillimet lidhur me procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës. Gjithashtu, ministri i FSK-së çmoi lartë kontributin e pjesëtarëve italianë që janë pjesë e KFOR-it dhe NLAT-it për mbështetjen e drejtpërdrejtë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri Demolli dhe ambasadori italian Ferrarese biseduan edhe për bashkëpunimin e mëtejmë të dyanshëm, për nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe për mundësinë e trajnimit të pjesëtarëve të FSK-së në kampin "Villagio Italia"në Pejë. Nga ana e tij, ambasadori italian z. Andreas Ferrarese shprehi kënaqësinë për pritjen që iu bë nga ministri Demolli dhe për bashkëpunimin e deritashëm në mes dy shteteve, posaçërisht në mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Italisë. Ambasadori Ferrarese në fund u shpreh se ky bashkëpunim do vazhdojë edhe në të ardhmen në mes dy shteteve mike dhe në mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Italisë.



FSK-ja përkujton 11 shtatorin e sulmeve terroriste në SHBA



Më 11 shtator 2015, në të gjitha kazermat e FSK-së, në orën 14:45 minuta, në shenjë nderimi dhe përkujtimi të viktimave të terrorit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të gjithë flamujt janë lëshuar në gjysmështizë si dhe është mbajtur një minutë heshtje.

Në kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, për t'i nderuar viktimat e sulmit terrorist të 11 shtatorit të vitit 2001 ishte edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Rrahman Rama, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi dhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli. Një fjalën e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama para pjesëtarëve të FSK-së dhe atyre amerikanë ndër të tjera tha: "Jemi këtu për t'i nderuar viktimat e sulmit terrorist të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sulmi i 11 shtatorit pati tronditur jo vetëm popullin amerikan por edhe popullin shqiptar. Populli i Kosovës kurrë nuk do ta harrojë ndihmën e jashtëzakonshme që SHBA-të dhanë për lirinë e saj, prandaj, edhe në këtë përvjetor shprehim falënderimin e veçantë për popullin amerikan dhe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës", përfundoi fjalën e tij komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Ndërsa, nënkoloneli amerikan, AA. RHUS, tha:" Jam shumë i lumtur, këtu para jush, kur ju shoh që ndani dhimbjen së bashku me ne, në nderim të viktimave të 11 shtatorit. Para një viti Kosovën e kam parë vetëm përmes televizionit dhe tani që gjashtë muaj jam këtu, në Kosovë dhe ndihem shumë i lumtur që Kosovën e kemi mikun më të ngushtë". Më 11 shtator të vitit 2001, terroristët sulmuan Kullat Binjake në Nju Jork të SHBA-ve, ku humbën jetën mijëra civilë të pafajshëm.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Bashkëpunim i frytshëm në mes Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë dhe MFSK-së



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), nga data 14 deri më 17 shtator, për një vizitë zyrtare pune po qëndron një delegacion i lartë nga Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Forcave të Armatosura të Gjermanisë, i përbërë nga komandantët e Marinës: Markus Brüggemeier, Markus Nolte, Herbert Kraus dhe nënkolonel Bernd Schales. Delegacioni gjerman, fillimisht në takime të ndara, u prit nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe sekretari i përgjithshëm i MFSK-së z. Shkëlzen Sylaj. Gjenerali Rama dhe z. Sylaj, me këtë rast, falënderuan delegacionin gjerman për bashkëpunimin dhe mbështetjen që Gjermania po jep për FSK-në në të gjitha fushat si në edukim, trajnim dhe shkëmbim të përvojave në fusha të ndryshme. Më pas, delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë zhvilloi takime pune me delegacionin e Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri të MFSK-së kryesuar nga drejtor i këtij departamenti, Kolonel Ilir Qeriqi, e ku merrnin pjesë: nënkolonel Hasan Hoxha, shef i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sinan Geci, shef i Sektorit për Integrime Euro-Atlantike. Gjatë këtij takimi u bisedua për programin vjetor të bashkëpunimit, për asistencën në trajnime ushtarake që ofrohet nga Forcat e Armatosura të Gjermanisë për vitin 2016. Këtë vit pala gjermane, ka ofruar edhe mundësinë për shkollimin e pjesëtarëve të FSK-së në Akademinë Ushtarake Gjermane. Në emër të delegacionit të Gjermanisë, Markus Brüggemeier, komandanti i Marinës duke falënderuar komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahmman Ramën dhe sekretarin e MFSK-së z. Sylaj, shprehu gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit edhe në fusha të tjera në mes dy ministrive.

Komandanti i FSK-së takoi atasheun ushtarak të Gjermanisë për Kosovë



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) më 16 shtator 2015, për një vizitë pune qëndroi atasheu ushtarak i Mbrojtjes i Republikës së Gjermanisë për Sarajevë dhe Kosovë, nënkolonel Martin Herrmann.Nënkolonelin Herrmann e priti komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, i cili pasi i uroi detyrën e re e njoftoi atasheun ushtarak me arritjet e përgjithshme dhe bashkëpunimin e deritashëm me Republikën e Gjermaninë në fushën e arsimimit dhe trajnimeve. Nga ana e tij, atasheu ushtarak i Gjermanisë, nënkoloneli Herrmann, shprehu falënderimin e tij për pritjen dhe njëherazi premtoi angazhim në përkrahjen e FSK-së. Në takim morën pjesë edhe kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK-së dhe major Berat Shala, këshilltar i komandantit.

Gjeneral Gëzim Hazrolli vizitoi kontingjentin e FSK-së gjatë ushtrimit fushor në Sllloveni

Në Republikën e Kroacisë dhe Sllovenisë, nga data 06 deri më 22 shtator 2015, është duke u zhvilluar ushtrimi fushor ,,Reagimi i Menjëhershëm 15", organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR) në bashkëpunim me Forcat e Armatosura të Republikës së Sllovenisë dhe Kroacisë. Në ushtrimin "Reagimi i Menjëhershëm 15" po merr pjesë edhe një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës me 11 pjesëtarë; oficerë stafi, oficerë për inteligjencë, mjekësi dhe vëzhgues kontrollues. Për të përcjellë ushtrimin nga afër në Kroaci-Sllloveni po merr pjesë edhe



zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli. Në finalizimin e ushtrimit Reagimi i Menjëhershëm 15" ishin të pranishëm presidenti i Sllovenisë Borut Pahor, ministrja e Mbrojtjes së Sllovenisë znj.Janka Vebera, ambasadori i Kosovës në Slloveni z.Nexhmi Rexhepi, gjeneral nga SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Kroacia, Sllovenia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Kosova si dhe udhëheqësit e lartë politikë dhe ushtarakë nga vendet pjesëmarrëse në ushtrim. Të pranishmit u njoftuan me punën dhe bashkëveprimin e të gjitha shteteve pjesëmarrëse në këtë ushtrim, duke shprehur gatishmërinë për veprime të përbashkëta kudo që paraqitet nevoja. Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjatë përcjellës së ushtrimit në Sllloveni, takoi shumë personalitete ushtarake dhe civile, si dhe pjesëtarët e FSK-së të cilët ishin pjesë e ushtrimit fushor "Reagimi i Menjëhershëm 15". Ai nga afër u njoh me rrjedhën e ushtrimit, me pjesëmarrësit tjerë në ushtrim, me sfidat me të cilat ata u ballafaquan, si dhe me përvojat që pjesëmarrësit fituan gjatë këtij ushtrimi. Zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral Hazrolli në emër të FSK-së dhe komandantit të FSK-së, falënderoi Ushtrinë Kroate dhe atë Sllovene për organizimin e këtij ushtrimi dhe kërkoi nga ta të ndihmojnë pjesëmarrjen e FSK-së në iniciativa të tilla bashkëpunimi dhe integrimi në mekanizma të sigurisë rajonale.

Shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, përcolli trajnimet në kuadër të përgatitjeve për "Shqiponja 4"

Shefi i Shtabit i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së kolonel Naim Haziri me stafin e lartë të KFT-së, më 23 shtator 2015, përcollën trajnimet në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë dhe në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj. Trajnimet janë duke u realizuar në bashkëpunim me ekipet mobile të Gardës Kombëtare të Ajovës, NLAT-it dhe SATMO-s, në vazhdën e përgatitjeve për ushtrimin fushor ,,Shqiponja 4", i cili do të mbahet në muajin tetor të këtij viti. Me këtë rast, kolonel Haziri(drejtor i ushtrimit fushor "Shqiponja 4") u njoftua nga afër me punën që janë duke bërë njësitet e FSK-së gjatë trajnimeve. Ai falënderoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së, si dhe ekipet mobile të Gardës Kombëtare të Ajovës, NLAT-it dhe SATMO-s, të cilët janë angazhuar në realizimin sa me sukses të këtij ushtrimi. Në fund, shefi i Shtabit të KFT-së kolonel Haziri kërkoi nga të gjithë pjesëmarrësit në ushtrim angazhim maksimal." Kërkoj nga ju që të angazhoheni sa më shumë gjatë këtij ushtrimi, pasi që ju keni një rol kyç në realizimin e ushtrimit fushor të planifikuar, gjithashtu kërkoi nga ju që t'i rishikoni të gjitha detajet dhe kufizimet të cilat mund të na paraqiten gjatë realizimit të ushtrimit". Edhe koloneli ALTMAN ka shprehur kënaqësinë e tij, për interesimin dhe angazhimin e pjesëtarëve të FSK-së në trajnimin përgatitor për ushtrimin fushor "Shqiponja 4".



Betohen kadetët e rinj të FSK-së, gjenerata 2015

Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore në Prishtinë, më 18 shtator 2015, u zhvillua ceremonia e dhënies së betimit të kadetëve të rinj të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, gjenerata 2015, shënimi i dhjetë vjetorit të themelimit të Qendrës për Studime Universitare dhe përurimi i objektit të ri të kësaj Qendre Universitare. Në ceremoni morën pjesë: ministri i MFSK-së Haki Demolli, zëvendësministrat Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneral brigade Timoty Orr, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së Shkëlzen Sylaj, përfaqësues të KFOR-it, të NLAT-it, përfaqësues të Ambasadës amerikane në Prishtinë, atashe ushtarakë, oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it, si dhe familjarë të kadetëve dhe të ftuar të tjerë.



PJESË NGA FJALA E MINISTRIT HAKI DEMOLLI, DREJTUAR KADETËVE TË RINJ TË FSK-SË

Me këtë rast, ministri i FSK-së z. Haki Demolli pasi përshëndeti pjesëmarrësit në ceremoninë e betimit të kadetëve, veç tjerash, tha: "Për Ministrinë e FSK-së, për Qendrën e Studimeve Universitare, por edhe për mua, dita e sotme është një ditë e rëndësisë së posaçme, sepse para oficerëve të FSK-së, para flamurit dhe para prindërve do të betohen kadetët e gjeneratës 2015, si dhe do të përurohet objekti i ri i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së. Ceremonia e sotme e Betimit të Kadetëve të rinj, pra të gjeneratës 2015, është edhe më e veçantë dhe më madhështore sepse po mbahet në vitin jubilar, pra në 10- vjetorin e themelimit të Qendrës së Studimeve Universitare Ushtarake, përkatësisht të Akademisë së Mbrojtjes të TMK-s, në kuadër të të cilës janë shkolluar dhe trajnuar me dhjetëra oficerë të FSK-së. Po ashtu e veçanta tjetër e këtij betimi është edhe prania e dy kadetëve nga Shqipëria, të cilët do të bëhen oficerë të Ushtrisë shqiptare, e që shkollimi i tyre në Qendrën tonë të Studimeve është rezultat i bashkëpunimit intensiv ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëpunim të kësaj natyre Ministria jonë është duke zhvilluar edhe me vendet tjera në rajon dhe më gjerë. Në kuadër të bashkëpunimeve të tilla, ne kemi dërguar kadetët tanë për studime në akademitë ushtarake të Maqedonisë, Kroacisë dhe Turqisë. Shkollimi i kadetëve tonë, në akademitë ushtarake të shteteve kandidate dhe anëtare të NATO-së, na bënë neve si Ministri që të ndihemi edhe më mirë edhe më krenarë, sepse jemi të vetëdijshëm se po përgatisim oficerët e ardhshëm të Forcës së Armatosur të Kosovës, sipas parimeve dhe standardeve të NATO-s. FSK është e përkushtuar që ta ndërtojë një forcë moderne e profesionale të sigurisë, të trajnuar mirë dhe të pajisur sipas standardeve të Aleancës Veri-atlantike. Për arritjen e këtij standardi nuk mjafton vetëm dëshira dhe përkushtimi i pjesëtarëve, por duhet ngritje profesionale dhe dije e avancuar, e kjo arrihet vetëm përmes shkollimit dhe trajnimit të kuadrove të reja.

Ministria e FSK-së këtë objektiv e arrin përmes Qendrës për Studime Universitare, në bashkëpunim me Universitetin Amerikan në Kosovë si dhe me Universitetet e tjera si në vend ashtu dhe jashtë vendit" Ju jeni përcaktuar për një studim më ndryshe se sa ai që zhvillojnë bashkëmoshatarët tuaj në institucionet tjera Universitare. Ju sot po e filloni shkollimin tuaj për të qenë të dobishëm jo vetëm për vetën tuaj, por në radhë të parë të vlefshëm dhe dobishëm për vendin dhe qytetarët e vendit tonë, e pastaj për vetën dhe familjet tuaja. Ju sot po merrni përgjegjësi të reja, po betoheni para flamurit, para prindërve, para komandantëve tuaj, që do të jeni të përkushtuar ndaj vendit, ndaj atdheut, duke pasur gjithmonë parasysh moton e ushtarakut: nderi, detyra dhe atdheu"Për themelimin respektivisht transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura, është duke u angazhuar me përkushtim sikurse Ministria e FSK-së ashtu edhe Qeveria e Kosovës dhe thellësisht jam i bindur, se deri në fund të këtij viti Kuvendi i Kosovës do të aprovojë bazën kushtetuese dhe ligjore për procesin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur, duke hapur kështu rrugën për zhvillimin e këtij procesi shumë të rëndësishëm për vendin tonë, rezultat i të cilit do të jetë ndërtimi i Forcës së Armatosur të Kosovës e cila jo vetëm që do të jetë e gatshme për të përmbushur misionin e saj kushtetues, por do të jep kontributin e vet edhe në stabilitetin regjional si dhe objektivë finale të saj do të ketë integrimin në mekanizmat euro-atlantik dhe anëtarësimin e saj në NATO.





GJENERALLEJTËNANT RRAHMAN RAMA: FSK-JA ËSHTË E PËRKUSHTUAR QË TA NDËRTOJË NJË FORCË MODERNE DHE PROFESIONALE

Për mua personalisht si komandant i FSK-së dhe për FSK-në, dita e sotme është e një rëndësie të veçantë sepse po shënojmë betimin e gjeneratës së njëmbëdhjetë të kadetëve, dhe të 10 vjetorin e themelimit të kësaj qendre universitare, për të shtuar; "Qendra për Studime Universitare u themelua në vitin 2005, sipas modelit të kolegjit ushtarak të SHBA-ve, për zhvillim dhe edukim të oficerëve të rinj. Kjo qendër ka fokus zhvillimin dhe edukimin e oficerëve të FSK-së, në mënyrë që të jenë në gjendje të udhëheqin dhe marrin vendime të drejta dhe në kohë. Nga kjo qendër, kanë diplomuar 78 oficerë dhe 45 tjerë janë në shkollim. Kjo është arritje e madhe për FSK-në, pasi që këta oficerë kanë përgjegjësi në udhëheqjen drejtpërdrejt të një pjese të madhe të FSK-së, në nivel kompanie dhe togu, dhe gjithsesi që do të jenë udhëheqësit e ardhshëm të Forcave të Armatosura të Kosovës. Me rastin e shënimit të vitit jubilar, kjo qendër po merr edhe karakter të qendrës rajonale për edukim dhe trajnim të oficerëve. Këtë vit për herë të parë kemi dy kadetë nga Shqipëria të cilët së bashku me kadetët tonë do t'i kryejnë studimet dhe trajnimin në QSU për katër vite". Gjeneral Rama përgëzoi stafin e QSU-së, të cilët për 10 vite kanë punuar dhe kontribuar në ngritjen dhe zhvillimin e kësaj qendre. FSK është e përkushtuar që ta ndërtojë një forcë moderne, profesionale, shumetnike, të trajnuar mirë dhe të pajisur me infrastrukturë sipas standardeve të ushtrive perëndimore. FSK është duke investuar shumë në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të vet, në të gjitha nivelet. Ne e kuptojmë, që pa personel të edukuar, trajnuar dhe të aftë nuk mund të arrijmë aspiratat tona të anëtarësimit në strukturat euroatlantike. Prandaj, FSK është duke krijuar kuadro që janë të aftë të udhëheqin, drejtojnë dhe marrin vendime. Këta të rinj para juve kalojnë nëpër një proces të gjatë dhe mjaft rigoroz, në mënyrë që të përzgjedhim më të mirët. Dhe para jush sot janë rreshtuar kadetët më të mirë, që me sukses i kanë kaluar të gjitha testimet, si dhe kanë përballuar me sukses javën mjaft sfiduese fizikisht dhe psikikisht dhe unë ju përshëndes dhe përgëzoj për këtë sukses".



Pas ceremonisë së betimit të kadetëve: Ardit Deliu, Ardit Gashi, Dardan Kajdomqaj, Denis Bitri, (Shqipëri) Dritëro Bajrami, Endrit Hate (Shqipëri), Hajzer Shyti, Ilirianë Bunjaku, Jeta Berisha, Samed Kadrija, Valdrin Ismajli dhe Ylli Abazi, solemnisht u bë edhe përurimi i objektit të ri të Qendrës për Studime Universitare, ku shiritin e prenë ministri Demolli, komandanti i FSK-së gjeneral Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr.

Gjenerali Timothy Orr: Ju jeni e ardhmja e këtij vendi dhe më këtë duhet të jeni krenarë



Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr, në betim e kadetëve të rinj të FSK-së, tha: "Është nder për mua që jam sot në Kosovë, pasi sot është një ditë historike për FSK-në. Sot bëhet betimi i kadetëve të rinj dhe shënohet 10-vjetori i Qendrës për Studime Universitare - dhjetë gjenerata kadetësh. Gjithashtu, sot bëhet përurimi i objektit të ri të kësaj qendre. Është hera e dytë për mua të jem pjesë e kësaj ceremonie dhe jam mjaft krenar për këtë. Ju jeni një për qind e popullit që prezantoni vendin tuaj me uniformë. Ju do jeni këtu kur populli të ketë nevojë për ju, si sot, nesër dhe në të ardhmen. Ju jeni e ardhmja e këtij vendi dhe më këtë duhet të jeni krenarë ju, familja juaj dhe e gjithë Kosova. Para një muaji isha pjesë e një ceremonie të tillë pasi edhe djali im është kadet dhe po flas në cilësinë e prindit, dhe të shohësh fëmijën duke ngritur dorën dhe bërë betimin është nder dhe krenari". Ju uroj gjitha të mirat, e ardhmja e juaj të ju sjell vetëm lumturi dhe sukses.



Në përfundimit të ceremonisë, familjarët bashkë me kadetët vizituan ambientet e QSU-së, ku u njoftuan me kushtet e kësaj qendre, në të cilën kadetët do të mësojnë dhe qëndrojnë për katër vjet gjatë studimeve.



Me një fjalë tematike është paraqitur edhe zëvendëskomandanti i KDS-së kolonel Irfete Spahiu, e cila ndër të tjerash tha: Jemi këtu për të shënuar një ngjarje të veçantë, betimin e 12 kadetëve të rinj të FSK-së, shënimin e dhjetëvjetorit dhe përurimin e objektit të ri të QSU-së. "Të betohesh do të thotë të marrësh përgjegjësi, se me çdo kusht do ta përmbushësh betimin. Juve kadetë të nderuar, ky betim jo vetëm që do të ju ngarkoj me përgjegjësi, por do të ju jep forcë dhe vullnet për ta realizuar ëndrrën tuaj. Sot është përvjetori i dhjetë i Qendrës për Studime Universitare, një dekadë e plotë me shumë punë, mund dhe padyshim edhe suksese. Kjo qendër ishte dhe vazhdon të mbetet edhe institucioni edukativo-arsimor më i besueshëm. Nga kjo qendër kanë dalë shtatë gjenerata dhe tri të tjera janë në proces. Nga ato gjenerata kanë dalë shumë oficerë të rinj të cilët tashmë janë pjesë e çdo angazhimi dhe me njësi të suksesshme. Po ashtu, sot në këtë ditë të veçantë do të bëhet edhe përurimi i objektit të ri të QSU-së, i cili do të përmirësojë kushtet e akomodimit dhe studimit. Unë ndjehem krenare me stafin e përkushtuar komandues dhe atë të instruktorëve të kësaj qendre, të cilët me punë, zell, angazhim dhe profesionalizëm po kontribuojnë në edukimin dhe arsimimin e kadetëve, të cilët po përbëjnë elitën e oficerëve të FSK-së.

Intervistë me nënkolonelin Gjerman Michael Gierse këshilltar në Departamentin e Logjistikës në MFSK

Secili ta japë kontributin në zhvillim profesional të FKS-së

Ftesës sonë për intervistë në gazetën e FSK-së "Forca Jonë" iu përgjigj me dëshirë nënkoloneli Michael Gierse, këshilltar në Departamentin e Logjistikës në MFSK. Kolegët e punës, në Departamentin e Logjistikës, thonë se nënkoloneli Gierse dallohet për bashkëpunimin dhe këshillimet e tij profesionale.

Gazeta "Forca Jonë": *Zoti nënkolonel, ju jeni emëruar këshilltar për çështje të logjistikës në MFSK. A mund të thoni diçka më shume?*
Nënkolonel Michael Gierse: Që nga prilli i vitit 2014 unë jam caktuar si këshilltar në Departamentin e Logjistikës në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, bazuar në marrëveshjen dypalëshe në mes të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë dhe MFSK-së. Forcat e Armatosura Gjermane dhe FSK-ja kanë një marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi. FSK-ja është konsideruar si një partner i yni strategjik dhe është planifikuar që të vazhdohet bashkëpunim i ngushtë me të edhe në të ardhmen.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është takimi juaj i parë me Kosovën-FSK-në, dhe cilat janë përshtypjet e juaja?*
Nënkolonel Michael Gierse: Eksperienca ime e parë me Kosovën kthehet prapa qysh në vitin 2002 dhe 2010 kur unë kam qenë pjesë e misionit të KFOR-it, të stacionuar në kampin Film City. Kështu që unë e njihja Kosovën shumë mirë kur erdha vitin e kaluar. Që nga fillimi jam trajtuar me respektin më të lartë dhe sinqeritetin mbresëlënës si dhe profesionalizmin e lidershipit të MFSK-së, duke qenë të etur për të ditur opinionin tim dhe të përdorin ekspertizën time në fushën e logjistikës.

Gazeta "Forca Jonë": *Ka dy vjet që punoni në Departamentin e Logjistikës së FSK-së, cilat janë risitë e këtij departamenti?*
Nënkolonel Michael Gierse: Një synim madhor i MFSK-së është të arrihen standardet e NATO-s. Komandanti i FSK-së ka vendosur të fokusohet në përdorimin e përvojës së logjistikës gjermane për zhvillimin e FSK-së. Detyra ime është që të mos instalojmë një sistem gjerman por të ofrojmë përvojën tonë që të ndërtojmë një sistem të logjistikës të besueshëm dhe të qëndrueshëm të FSK-së. Ky orientim është po ashtu i pasqyruar në programin bilateral vjetor të FSK-së për vitin 2016 i cili parasheh trajnime në Kosovë dhe Gjermani. Zyra ime në Prishtinë, nga janari i vitit të ardhshëm, do të përforcohet nga një ekspert i mirëmbajtjes.





Gazeta "Forca Jonë": *Ju lutem a mund ta bëni një paralele me nivelin e Departamentit të Logjistikës së FSK-së me atë të Ushtrisë suaj?*
Nënkolonel Michael Gierse: Nuk është ideja që të krahasohet sistemi logjistik i Forcave të Armatosura të Gjermanisë me atë të FSK-së, por që të përdoret përvoja gjermane për të vendosur dhe konsoliduar një sistem i cili është i dizajnuar posaçërisht për nevojat e tanishme dhe të ardhshme të FSK-së. Eksperienca ime në logjistikë është e bazuar në karrierën tipike të një oficeri të logjistikës për një kohë prej 30 vitesh; Unë kam qenë komandat i transportit dhe Batalionit të Logjistikës si dhe kam punuar në komanda të larta si oficer i stafit të logjistikës. Pastaj jam caktuar për tre vite në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s në Spanjë dhe kam kaluar më shumë se dy vite si këshilltar i logjistikës në Afganistan.

Gazeta "Forca Jonë": *Ju lutem nënkolonel, cili është bashkëpunimi me nëpunësit e Departamentit të Logjistikës dhe në përgjithësi të MFSK-së?.*
Nënkolonel Michael Gierse: Bashkëpunimi në Departamentin e Logjistikës dhe me zyrat e tjera të MFSK-së është bazuar në besimin e ndërsjellët dhe sinqeritet. Temat janë diskutuar me sinqeritet dhe ka pasur diskutime të shpeshta për të gjetur përgjigjet dhe zgjidhjet më të mira për sfidat ekzistuese. Unë jam integruar shume mirë këtu dhe aspak nuk ndjehem i huaj.

Gazeta "Forca Jonë": *Mesazhi juaj, ose ndonjë pyetje që nuk ju kam pyetur?*
Nënkolonel Michael Gierse: Duke punuar në MFSK për një vit e gjysmë, unë vërej një progres substancial, i cili është arritur nga puna e madhe dhe shumë e lartë profesionale ushtarake dhe civile e pjesëtarëve të FKS-së, duke u fokusuar në integrime Euro-Atlantike dhe partneritet shumetnik. Si shtesë, bazuar në eksperiencën time me personel që nga viti 2002 deri në vitin 2010, unë kam zbuluar zhvillimin e madh që ka bërë ky shtet drejt standardeve të mesme evropiane në shumë sektorë. Unë i kuptoj të rinjtë që ndonjëherë janë të padurueshëm, por jam i sigurt që Kosova është në rrugë të mirë dhe se populli i saj duhet të jetë krenarë. Secili duhet të kontribuojë në këtë zhvillim të mrekullueshëm sa më shumë që është e mundur.

Oficerë nga Akademia Ushtarake e Turqisë vizituan FSK-në



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 3 shtator 2015, për një vizitë treditore qëndroi delegacion i kadetëve nga Akademia Ushtarake Ajrore e Republikës së Turqisë. Delegacionin e priti drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK gjeneral brigade Zymer Halimi, i cili e falënderoi komandantin e Regjimentit të Akademisë Ushtarake Ajrore të Turqisë, kolonel Huseyin Ergezen, për ndihmën që Ushtria e Turqisë po jep për shkollimin e kadetëve dhe oficerëve të FSK-së në Akademitë Ushtarake të Turqisë. Më pas, të dy delegacionet biseduan edhe lidhur me vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit në mes të FSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë. Në takim morën pjesë edhe nënkolonel Hasan Hoxha, shef i Sektorit për Bashkëpunim në MFSK, atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovës nënkolonel Necdet Ozdemir dhe këshilltari ushtarak turk në FSK kolonel Gultekin Varal. Ndërsa, nënkoloneli Sefer Isufi përmes një prezantimi e njoftoi delegacionin nga Turqia për të arriturat e përgjithshme të FSK-së.

Pjesëtarët e FSK-së, pjesë e seminarit ndërkombëtar të nënoficerëve të lartë në Qendrën "Marrshall" në Gjermani

Në organizim të NATO-s dhe EUCOM-it, nga data: 13-18 shtator 2015, në Qendrën Evropiane të Studimeve të Sigurisë George C. Marshall në Gjermani u mbajt seminari ndërkombëtar i nënoficerëve të lartë. Në seminarin ndërkombëtar morën pjesë 41 pjesëtarë nga komandat dhe vendet e NATO-s, EUCOM-it, dhe vendet partnere, kurse Kosovën e përfaqësoi rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj. Ky seminar organizohet çdo vit dhe qëllimi kryesor është që të sinkronizohen aktivitetet e përbashkëta, rritja e autoritetit të nënoficerëve, ngritja profesionale e ushtarëve etj. Ndërsa, objektivat e seminarit siç ishte rritja e bashkëpunimit, sfidat në operacionet e tanishme, rritja e edukimit dhe zgjerimi i programeve edukuese, ndarja e eksperiencave dhe sukseseve u realizuan plotësisht. Krahas këtij seminari, liderët pjesëmarrës kishin sesione të përbashkëta edhe me kolegët nga Seminari i Lartë Ekzekutiv, ku u trajtuan problemet dhe trendët globale. Mysafir nderi i këtyre dy seminareve ishte gjenerali Philip M. Breedlove, Komandanti Suprem i Forcave Aleate për Evropë i cili shprehi përkushtimin e tij, për përkrahje të vazhdueshme të vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere në përballjen e sfidave të përbashkëta. Ky seminar është ngjarja më e madhe e organizuar në nivelin e nënoficerëve të lartë. Organizimi i sivjetshëm ishte i dymbëdhjeti me radhë dhe Kosova merr pjesë vazhdimisht që nga viti 2011.



Oficerët e FSK-së po trajnohen në Kolegjin e Shtabit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë

Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Gjermanisë dhe në kuadër të programit të trajnimit për oficerë të shtabit të rangut Gjeneral/Admiral, në Kolegjin e Shtabit të Përgjithshëm të Akademisë së Udhëheqësve në Hamburg po përfitojnë edhe oficerë të FSK-së. Kolegji i Shtabit të Përgjithshëm i Akademisë së Udhëheqësve në Hamburg të RF të Gjermanisë punën e ka filluar në vitin 1962, ku trajnoheshin oficerët vendorë dhe ndërkombëtarë nga kombe jashtë NATO-s, në funksionet e përgjithshme të shtabit vetëm për oficerë të ushtrisë tokësore. Nga viti 1986 filloi trajnimi edhe në programin e forcave ajrore dhe







atyre detare. Pranimi i kandidatëve ndërkombëtarë për këtë kolegj, bëhet duke u bazuar në memorandumet dypalëshe të bashkëpunimit që Ministria Federale e Mbrojtjes ka me shtetet që ftohen për të marrë pjesë në kolegj. Që nga viti 2013, këtë kolegj e kanë kryer major Muharrem Sylejmani (2013-2014) dhe nënkolonel Ajet Potera (2014-2015), ndërsa kandidati i radhës është nënkoloneli Haki Hoti i cili është duke ndjekur programin dhe është radhitur ndër dy oficerët më të suksesshëm të kësaj gjenerate. Kurse në kursin parapërgatitor për gjuhë është edhe Major Afrim Shala. Më 17. 09. 2015, nënkolonel Haki Hoti, para stafit udhëheqës të Akademisë, e ku merrnin pjesë edhe atasheu i FSK-së në Republikën Federale të Gjermanisë, kolonel Xhavit Sadrijaj dhe oficerë të lartë të 49 kombeve pjesëmarrëse, prezantoi Republikën e Kosovës, fokusuar në rrjedhën e proceseve që nga kohët e lashta e deri me zhvillimet më të reja; si zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës dhe rolin e tyre në sigurinë rajonale. Që nga viti 1962 e deri më 2014, këtë kolegj e kanë kryer 2400 oficerë nga 120 vende të ndryshme, një e katërta e të trajnuarve janë gjermanë. Ndërsa, komandanti i kolegjit koloneli Kohnen shprehi vetëm fjalë të mira për oficerët e FSK-së, të cilët kanë kryer dhe po vazhdojnë të kryejnë trajnim në këtë kolegj. Ai lavdëroi angazhimin e atasheut të FSK-së, kolonelin Xhavit Sadria, i cili vazhdimisht po i mbështetë oficerët e FSK-së gjatë trajnimit në Gjermani.

Certifikohen pjesëtarë të FSK-së në trajnimin "Zhvillimi i nënoficerëve shtaborë"

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, më 19 shtator 2015, përfundoi trajnimi " Zhvillimi i nënoficerëve shtabor" ku morën pjesë 23 pjesëtarë të njësive të FSK-së. Trajnimi u realizua nga ekipi mobil i Gardës Kombëtare të Shtetit të Ajovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në emër të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ekipin e instruktorëve nga SHBA-ja, shefin e ODC-së dhe të gjithë pjesëmarrësit e këtij trajnimi i falënderoi rreshter major Fetah Zejnullahu. Ai, nder të tjera, shtoi: "Duke u bazuar në eksperiencën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ne jemi duke bërë maksimumin për zhvillimin e nënoficerëve të FSK-së, pasi që motori i çdo ushtrie janë nënoficerët dhe ushtarët". Edhe instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës u shprehen mjaft të kënaqur me zhvillimin e trajnimit dhe rëndësinë që ka për Forcën e Sigurisë së



Kosovës zhvillimi i nënoficerëve shtabor. Ata kërkuan që njohuritë e marra nga ky trajnim të zbatohen sa më shpejt që të jetë e mundur nëpër të gjitha njësitet e FSK-së. Ndërsa, major DIETZLR, nga ekipi i instruktorëve të SHBA-ve, falënderoi për mikpritjen dhe i përgëzoi pjesëtarët për nivelin e dijes që kanë treguar gjatë këtyre ditëve. Në fund të gjithë pjesëmarrësit u nderuar me certifikata, ndërsa instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës u nderuan me mirënjohje.

Nderohet me mirënjohje znj. Kathryn Byndyn nga SHBA-të



Në Ministrinë e FSK-së për një vizitë zyrtare qëndroi zonja Kathryn Bundy, një mike e madhe e shqiptarëve nga SHBA-të. Ajo u prit nga drejtori për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK koloneli Ilir Qeriqi, i cili në emër të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramës znj. Byndy i ndau mirënjohje me motivacionin "Për kontributin e dhënë në ndihmë oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së në Shtetet e Bashkuara të Amerikës". Zonja Kathryn Bundy është qytetare e SHBA-ve në pension, e cila shërben vullnetarisht në Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në kuadër të programit për sponsorizimin e studentëve të huaj në Qendrën e Ekselencës për Manovër të Ushtrisë së SHBA-ve në Fort Benning të shtetit Gjeorgjia. Znj. Byndy ka ndihmuar më shumë se 20 oficerë dhe nënoficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për gjatë gjithë kohës sa kanë qëndruar në trajnime përkatëse, përkundër faktit se programi në të cilin ajo shërben nuk kërkon të sponsorizohen më shumë se një student. Në shtator 2014, znj. Bundy ka sponsorizuar 11 oficerë shqiptarë duke përfshirë edhe tre nga Kosova. Është hera e tretë që znj. Bundy viziton Kosovën. Gjatë vizitës së saj ajo viziton edhe oficerët dhe familjet e tyre. Edhe pse në moshë të shtyrë dhe me shëndet të dobët, nuk ndalet se ndihmuari kadetët e FSK-së që shkojnë për studime në SHBA. Ka njohuri të shumta për kulturën, traditat dhe historinë tonë. Kështu, pak nga pak, po arrin të mësojë të flas edhe gjuhën shqipe.

Portrete të dalluar sportistësh në FSK

Ushtare Saranda Grajçevci, kampione e Kosovës në volejboll

Saranda me klubin e volejbollit "Mabetex" fitoi katër herë titullin e kampiones dhe Kupën e Kosovës

Në Forcën e Sigurisë së Kosovës ka shumë sportistë të dalluar në shumë sporte, si në: futboll, hendboll, volejboll, shenjëtari, atletikë etj. Njëra ndër sportistet më të dalluarat është edhe Saranda Grajçevci, ushtare e FSK-së, e cila shërben në Batalion e Parë të Reagimit të Shpejtë në Gjilan. Saranda është volejbolliste e talentuar që me punë maksimale ka arrit në nivelet më të larta të këtij sporti mjaft atraktiv. Saranda qysh në moshën e re, si nxënëse e shkollës fillore në Prishtinë, u dashurua me volejbollin dhe që prej atëherë ajo është shumë aktive dhe e suksesshme në të gjitha etapat dhe klubet në të cilat ka luajtur. Saranda, një vajzë me trup prej atleteje dhe me fizik të zhvilluar ka luajtur me klubin e volejbollit "Mabetex", KV." AAB", KV. "Prishtina", KV" Drenasi" dhe klube të tjera të volejbollit në Kosovë. Hapat e parë i bëri në klubin e volejbollit "Universiteti-Mabetex" në Prishtinë. Saranda tani shërben në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe e ndien vetën shumë krenare për këtë, sepse edhe puna këtu, falë angazhimeve dhe aktiviteteve fizike që kryen në FSK, i jep mundësi të shumta në rritjen e rezultateve të saja. Saranda gjatë periudhës 15 vjeçare, si volejbolliste ka pasur momente shumë të lumtura, suksese të njëpasnjëshme, me klubin "Mabetex" 2004-2008 nga Prishtina, ku katër herë ka fituar titullin Kampion i Kosovës dhe katër herë Kupën e Kosovës, si dhe një herë Super Kupën Kombëtare. Rezultateve të Sarandës do t'ia kishin lakmi edhe sportist me nam, prandaj kjo e bën Sarandën sportiste të dalluar e cila kontributin ia dedikon shoqeve dhe trajnerëve të saj. Saranda pas KV "Mabetex", luajti edhe me klubin e volejbollit të Universitetit AAB 2008-2010 në Prishtinë, ku edhe këtu shpallet Kampion i Kosovës dhe fiton Kupën e Kosovës. Gjithashtu, Saranda edhe me klubin e volejbollit "Prishtina" 2011-2013, dy herë shpallet Kampion i Kosovës dhe njëherë fituese e Kupës së Kosovës. Të gjitha këto suksese të Sarandës nuk ka qenë lehtë të arrihen, duke pas parasysh edhe angazhimet dhe punën e saj në Forcën e Sigurisë së Kosovës, por ajo falënderon kolegët dhe eprorët e saj për mirëkuptimin që kanë për të, dhe shpreson që në të ardhmen të krijojë një klub të volejbollit në FSK. Saranda thotë se në FSK ka shumë talente në sporte të ndryshme, gjithashtu edhe volejbolliste të dalluara. FSK-ja ka të gjitha kushtet për zhvillimin e të gjitha llojeve të sporteve Ajo thotë se vetëm me punë të palodhshme, me dashuri dhe përkushtim arrihen rezultate të shkëlqyeshme, po nuk pate dashuri nuk mund të bëhesh kampion. Këtë vit, Saranda ka arrit marrëveshje me KV. "AAB" nga Prishtina, ku synon paraqitje sa më të mira dhe shpreson në arritjen e rezultateve sa më të larta. Dëshira e Sarandës, si e çdo sportisti tjetër, është titulli i kampionit si dhe pjesëmarrja në garat ndërkombëtare, pasi që këtë vit edhe volejbolli u pranua në garat ndërkombëtare. Ne u ndamë nga Saranda duke i uruar që edhe këtë vit të stoliset me titullin Kampion i Kosovës dhe me medalje të Kampionit dhe të Kupës së Kosovës.





FORCA JONË

Viti IV Nr. 40 Nëntor 2015 Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës

FSK-ja në Konferencën Rajonale Karta e Adriatikut 5 -SHBA, në Kroaci

Ministri Haki Demolli kërkon anëtarësim të Kosovës në iniciativa rajonale

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli në Dubrovnik kërkoi për Kosovën anëtarësim me të drejta të plota në iniciativa rajonale dhe globale të sigurisë. Demolli dhe delegacioni nga ministria, më 22 tetor 2015, ishin pjesë e të dyja sesioneve të Takimit Rajonal Gjithëpërfshirës të Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Juglindore, si dhe atij të ministrave të Mbrojtjes të vendeve në kuadër të A5- Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) Karta e Adriatikut. Ministri Haki Demolli në fjalën e tij theksoi interesin dhe angazhimin e Republikës së Kosovës në promovimin e stabilitetit, sigurisë rajonale dhe evropiane, por gjithashtu edhe interesin e Republikës së Kosovës për anëtarësimin në të gjitha iniciativat rajonale dhe strukturat globale të sigurisë. Ministri Demolli foli edhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, duke u shprehur se Forca e ardhshme do të jetë forcë për të mirën e qytetarëve të saj dhe do të kontribuojë për paqen dhe stabilitetin në rajon e më gjerë dhe duke rikonfirmuar se Forca e Armatosur e Kosovës do të ndërtohet mbi parime të larta demokratike si dhe mbi standardet e NATO-s. Në takimin e ministrave të Mbrojtjes të vendeve të regjionit në Dubrovnik, ministri i FSK-së, Haki Demolli shprehu gatishmërinë që me kapacitetet aktuale që ka FSK-ja Kosova të jap kontributin e saj në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë, pra Demolli tha se FSK-ja është e gatshme që të kontribuojë në operacione të shkatërrimit të mjeteve të pashpërthyera, në kërkim- shpëtim, mjekësi dhe polici ushtarake dhe me këtë të kontribuojë në paqen dhe sigurinë globale. Gjithashtu ministri Haki Demolli ka zhvilluar edhe takime dypalëshe me ekipin amerikan të udhëhequr nga Dr. Evelyn Farkas, ku u diskutuan çështje të bashkëpunimit dypalësh, si dhe u fol për mbështetjen që ShBA po i jep Kosovës në iniciativat rajonale. Takime të ndara dypalëshe, ministri Demolli zhvilloi edhe me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, Zoran Jolevski, ministren e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, zonjën Mimi Kodheli, si dhe me ministrin e Mbrojtjes të Kroacisë, Ante Kotromanovic, me të cilët u diskutua bashkëpunimi



dypalësh dhe vazhdimi i thellimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme, si në fushën e trajnimit dhe arsimimit. Takimi i dytë ishte takimi i drejtorëve për Politika të Mbrojtjes, ku MFSK -në e ka përfaqësuar drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Faruk Geci. Në këtë takim u diskutuan sfidat e sigurisë rajonale dhe mundësitë e zhvillimit të mëtutjeshëm të projekteve aktuale, si dhe iniciativat për projekte të reja në të ardhmen. Në ditën e parë të takimit u zhvilluan dy konferenca të nivelit shumëpalësh si, ai i ministrave të Mbrojtjes me temë: ,,Perspektiva e ardhshme e Kartës së Adriatikut- kontributi në operacione paqeruajtëse, projektet në vazhdimësi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe projektet e ardhshme të bashkëpunimit. Takimi u organizua në dy sesione Temat e takimit përfshinin debatin strategjik mbi sfidat e sigurisë që kërcënojnë sigurinë evropiane, me fokus të veçantë në rajonin e Evropës Juglindore, si dhe pritjet nga Samiti i NATO-s i cili do të mbahet në Varshavë në korrik të vitit 2016.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në konferencën e ushtrive të Evropës

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama me ftesë të organizatorit, më 27 tetor 2015, mori pjesë në punimet e konferencës vjetore të ushtrive të shteteve të Evropës, sponsorizuar nga Komanda e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara për Evropë (U.S. Army Europe), që u zhvillua nga 27-28 tetor, në kazermën ,,Lucius D. Clay", në Wiesbaden të Republikës Federale të Gjermanisë. Gjeneral Rama ishte pjesë e konferencës në të cilën morën pjesë shefat e mbrojtjes të 26 shteteve anëtare të Aleancës Veri Atlantike(NATO) dhe gjithashtu edhe 10 shteteve partnere të NATO-s. Punimet e konferencës vjetore të ushtrive të shteteve të Evropës i kryesoi Komandanti i përgjithshëm i Komandës së



Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges. Në konferencën vjetore të ushtrive të shteteve të Evropës u diskutua mbi kërcënimet dhe sfidat aktuale të sigurisë në Evropë, si dhe ballafaqimi me krizën e refugjateve dhe emigrantëve. Në sesionin e dytë të konferencës u diskutuan sfidat dhe nevojat e së ardhmes për ushtritë e shteteve anëtare të paktit NATO dhe ushtritë e shteteve tjera të Evropës. Gjatë konferencës, gjeneral Rama është takuar me shefa të mbrojtjes të ushtrive të Evropës, shefin e Shtabit të përbashkët të ShBA-ve, si dhe me gjeneralë të Ushtrisë amerikane.

U mbajt konferenca "FSK dhe Partnerët"

Në lokalet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 15 tetor 2015, zhvilloi punimet konferenca ,,FSK dhe Partnerët", të cilën e organizoi Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar i MFSK-së, ku morën pjesë atashe ushtarakë të shumë vendeve partnere të akredituar në vendin tonë dhe në rajon. Në hapje të konferencës ishin të pranishëm edhe ministri i FSK-së Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj, gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Bashkim Jashari, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtori për Politika dhe Plane Faruk Geci, shefi i Komandës së Forcave Tokësore kolonel Naim Haziri, drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s për Ministrinë Dominic-Haydn Braithwaite, drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në gjeneral brigade Stefan Fix, atashetë ushtarakë të vendeve si; Republika e Shqipërisë, **(Vijon në faqen 2)**



Ministri Haki Demolli priti Sekretarin Parlamentar të Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë

Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, më 5 tetor 2015, priti një delegacion të Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë Federale të prirë nga Sekretari Parlamentar i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë, z.Markus Grubel. Ministri Demolli e falënderoi delegacionin e Gjermanisë për ndihmën e vazhdueshme që Gjermania po jep për Kosovën dhe në veçanti për FSK-në. Z. Demolli theksoi se një rol të rëndësishëm në këtë drejtim po luajnë edhe instruktorët gjermanë të cilët janë duke shërbyer në MFSK, në NLAT dhe NAT. Nga ana e tij, Sekretari Parlamentar i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë, zoti Markus Grubel, premtoi vazhdimin e bashkëpunimit në mes dy ministrive dhe dy forcave në të gjitha fushat me interes të dyanshëm, si dhe angazhimin për integrimin e FSK-së në strukturat euroatlantike. Delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë pati takime të ndara edhe me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe sekretarin e përgjithshëm të MFSK-së, zotin Shkëlzen Sylaj. Gjatë këtyre takimeve të dy delegacionet biseduan për fushat e bashkëpunimit në të ardhmen, si arsimimin dhe trajnimet. Gjithashtu edhe sekretari i MFSK-së, z. Sylaj, e njoftoi homologun e tij gjerman me zhvillimet në MFSK.

Në takimin ishin të pranishëm edhe zëvendësministrat Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, këshilltarët e ministrit; Xhevdet Halili dhe kolonel Fadil Hadërgjonaj, ndërsa pjesë e delegacionit nga Gjermania ishin; gjeneral brigade Wolf Jurgen Stahl, drejtori i NLAT-it, gjeneral Brigade Linux Fix, kolonel lejtënant Hauke Lutzen dhe zoti Bernd Saure.



Ministri i FSK-së takoi ministrin e Mbrojtjes dhe Sporteve të Austrisë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli, më 29 tetor, u takua zyrtarisht me ministrin e Mbrojtjes dhe Sporteve të Austrisë, Gerald Klug, i cili ishte pjesë e delegacionit me rastin e vizitës së Presidentit të Austrisë në Kosovë. Me këtë rast ministri i FSK-së, Haki Demolli shprehu falënderimin për kontributin që ka dhënë dhe po jep kontingjenti austriak në kuadër të KFOR-it në Republikën e Kosovës, pastaj edhe për kontributin e ushtarakëve austriak në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s për FSK-në(NAT), duke u shprehur se roli i shtetit të Austrisë në Kosovë në fushën e sigurisë ka qenë dhe vazhdon të jetë me rëndësi të veçantë. Ministrat Demolli dhe ai austriak Klug biseduan edhe për iniciativën e arritjes së marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së



Mbrojtjes dhe Sporteve të Austrisë, në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, marrëveshje kjo e cila do të konkretizonte fushat dhe aktivitetet e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe të dyja vendeve mike. Takimi ndërmjet ministrit të FSK-së dhe ministrit të Mbrojtjes dhe Sporteve të Austrisë u zhvillua në Prishtinë, në kuadër të vizitës që Presidenti i Austrisë e zhvilloi në Republikën e Kosovës.

Ministri i FSK-së Haki Demolli priti ambasadorin e Austrisë Johann Brieger

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, më 9 tetor, priti ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Johann Brieger. Ministri Demolli pasi përshëndeti ambasadorin e falënderoi atë, duke shprehur mirënjohjen e tij të thellë për ndihmën e pakursyer që vendi i tij ka dhënë dhe po vazhdon të jep për Kosovën. Gjatë takimit, ministri Demolli e njoftoi ambasadorin Brieger me zhvillimet e reja në MFSK, me theks të veçantë zhvillimet rreth procesit të transformimit të FSK-së, përgatitjet që janë bërë deri më tani dhe procedurat nëpër të cilat duhet të kalojë ky proces, përkatësisht sfidat me të cilat do të ballafaqohet. Ministri shfaqi interesim të posaçëm lidhur me nismën për nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Austrisë. Nga ana e tij, ambasadori Johann Brieger pasi shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin e deritashëm në mes dy shteteve, premtoi angazhimin e tij për intensifikimin e bashkëpunimit në mes të dy ministrive, në fushat me interes të përbashkët.



U mbajt konferenca „FSK dhe Partnerët"

(Vijon nga faqja 1)

Kroacisë, SHBA-ve, Turqisë, Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar, Italisë si dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile, e gjithashtu edhe pjesëmarrës tjerë nga fusha e sigurisë, qoftë të misioneve ndërkombëtare dhe oficerë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së. Qëllimi i konferencës së përbashkët "FSK dhe Partnerët", është rritja e ndërsjellë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes të partnerëve, po ashtu edhe me Ekipet këshilluese të NATO-s për Ministrinë (NAT) dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në (NLAT), si organizma mbështetës të MFSK-së dhe të FSK-së. Në fjalën e hapjes, ministri i FSK-së Haki Demolli tha se çmon lartë angazhimin e shteteve partnere në drejtim të rritjes së bashkëpunimit, ofrimit të ndihmës si dhe gatishmërisë për të thelluar edhe më tutje bashkëpunimin ndërmjet vendeve partnere me MFSK-në dhe me FSK-në. Ministri Demolli çmoi lartë angazhimin e atasheve ushtarakë të vendeve mike si dhe atasheve tanë në këto vende për shkallën e bashkëpunimit dhe të koordinimit e në veçanti rolin e dy mekanizmave këshillues të NATO-s për Ministrinë dhe FSK-në, siç janë NAT dhe NLAT. Në fund Ministri Demolli tha se MFSK-ja do të jetë transparente gjatë procesit të transformimit në Forca të Armatosura si për faktorët vendorë ashtu edhe për ata ndërkombëtarë. Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se e vlerësojmë lart gatishmërinë e vendeve partnere dhe vendeve pjesëmarrëse në konferencë, për të qenë afër nesh dhe për të parë sukseset dhe njëkohësisht edhe nevojat tona për të ardhmen. Më tej, gjeneral Rama tha se ne si FSK ju jemi shumë mirënjohës për angazhimin në përkrahje të profesionalizimit dhe gatishmërisë për të identifikuar fusha të reja të bashkëpunimit në përputhje me nevojat tona. Nga ana e tij, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Stefan Fix tha se ndjehet i lumtur që Ministria dhe FSK-ja kanë partnerë dhe miq serioz. Ai po ashtu tha se çmon lart angazhimin e Ministrisë dhe FSK-së për t'i ruajtur dhe për t'i zgjeruar këto raporte edhe me shumë vende tjera. Kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar referoi mbi temën; „ Bashkëpunimi i FSK-së me Partnerët", në të cilën njoftoi në detaje mbi marrëveshjet e bashkëpunimit me shume vende të botës, partneritetin shtetëror me Aiovën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe i bëri të ditura disa prej shteteve, me të cilat jemi siç tha Ai në prag të nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit.

Në vazhdim të punimeve të konferencës "FSK dhe Partnerët" prezantuan dhe diskutuan shumë prej pjesëmarrësve, të cilët në vazhdimësi theksuan gatishmërinë për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit. Në konferencën e 3-të „FSK dhe Partnerët" morën pjesë atashetë ushtarakë të ShBA-ve, Gjermanisë, Kroacisë, Maqedonisë, Shqipërisë, Turqisë dhe nga shumë vende të tjera, si dhe atashetë ushtarakë të Kosovës, të cilët shërbejnë nëpër vende të ndryshme, si kolonel Xhavit Sadrijaj në Gjermani, nënkolonel Bekim Osmani në Turqi, nënkolonel Ahmet Ajeti në Bruksel i akredituar për vendet e Beneluksit, nënkolonel Enver Dugolli në Shqipëri dhe major Sefer Isufi në Suedi. Të gjithë atashetë ushtarak të vendeve partnere, pjesëmarrës në konferencë, është paraparë që të përcjellin operacionet përfundimtare të ushtrimit fushor të FSK-së „Shqiponja 4"

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Betohen 170 ushtarë të rinj për shërbim në FSK

Nga sot radhëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) iu shtuan edhe 170 ushtarë të rinj të cilët u betuan pas certifikimit me rastin e përfundimin me sukses të trajnimit bazik. Ceremonia e betimit dhe certifikimit u zhvillua në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së në Ferizaj. Pas parakalimit të rekrutëve, revistës së trupave nga kolonel Irfete Spahiu, zëvendëskomandante e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, intonimit të himnit shtetëror të Kosovës, filloi ceremonia zyrtare e certifikimit të rekrutëve të rinj të FSK-së, në prani të ushtarakëve, oficerëve dhe familjarëve të tyre. Në fjalën e tij, ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli e vlerësoi lartë ceremoninë e betimit dhe të certifikimin të rekrutëve të rinj, të cilët po i shtohen radhëve të FSK-së. Me këtë rast, ministri Demolli iu drejtua ushtarëve të rinj me këto fjalë: „ Të dashur rekrutë të rinj dje, ushtarë të rinj sot, të rreshtuar para nesh, të mbushur me krenari, motivim dhe gëzim, duke reflektuar shpresën për një të ardhme më të sigurt, mos harroni se nuk ka mision më të shenjtë se detyra e juaj, ushtarë në shërbim të mbrojtjes së lirisë, paqes dhe demokracisë, vlera dhe parime këto për të cilat gjenerata të tëra u angazhuan dhe sakrifikuan shumë." Më tej, ministri Demolli tha se beson thellësisht dhe është i bindur se zelli, disiplina, motivimi dhe përkushtimi që i ka përcjellë rekrutët deri sot, për t'u përgatitur që ata të jenë të gatshëm të ballafaqoheni me obligimet dhe detyrat fillestare të ushtarit të FSK, do t'i shoqërojnë dhe do të jenë pjesë e aktivitetit dhe punës së tyre gjatë gjithë kohës së shërbimit tyre në FSK. Ministri Demolli njëherësh përgëzoi stafin e KDS për përgatitjen, trajnimin dhe transmetimin e përvojave të tyre profesionale tek rekrutët e rinj të FSK-së, duke shtuar se ushtarët e rinj po certifikoheni në një moment të rëndësishëm të ndërtimit të kapaciteteve mbrojtëse të shtetit tonë, po certifikohen në kohën kur janë bërë planifikimet dhe përgatitjet e duhura për trans-





formimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Në fund, ministri Demolli premtoi bashkëpunim dhe përkrahjen pa rezervë të stafit të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës për rekrutët, duke shtuar se „Ne do të angazhohemi dhe do të punojmë në krijimin e kushteve optimale, sigurimin e pajisjeve moderne, programeve arsimore dhe stërvitëse për pjesëtarët tanë që në çdo kohë të jenë të aftë dhe të gatshëm për përmbushjen e misionit dhe detyrave kushtetuese". Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij, tha se e di që rrugëtimi i rekrutëve, ushtarëve të rinj nuk ishte i lehtë sepse gjatë kursit bazik ata kishin sfida fizike dhe psikike, por Ju, shtoi komandanti i FSK-së ja dolët që sot të certifikoheni dhe të jepni betimin për të shërbyer si ushtarë të Kosovës. Më tej, gjeneral Rama tha se në këtë sfidë të përbashkët ushtarët e rinj mësuan për disiplinën dhe për vlerat që duhet t'i kenë ushtarakët, ata gjithashtu mësuan se si të përkujdesen për njëri- tjetrin dhe si ta mbështesin njëri- tjetrin gjatë zbatimit të detyrave, sepse profesioni i ushtarakut kërkon punë ekipore dhe vetëm si të tillë, pra si ekip, mund ta përmbushim misionin me sukses. Komandanti i FSK-së, në fund të fjalës së tij, iu drejtua ushtarëve të rinj me këto fjalë: „Ushtarë të rinj të Kosovës, Ju zgjodhët një profesion fisnik për t'i shërbyer vendit dhe qytetarëve tanë pa dallim, atëherë kur ata kanë nevojë më së shumti, por duhet të keni parasysh se zhvillimi juaj profesional nuk përfundon këtu dhe për këtë ju duhet të angazhoheni më tutje për zhvillimin tuaj profesional dhe personal." Dhe, fare në fund duke ju dëshiruar shëndet ushtarëve të rinj, gjenerali Rama iu drejtua atyre me porosinë që të jenë ushtarë të disiplinuar, të gatshëm dhe me integritet, t'i respektojnë urdhrat e drejtuesve, t'i kryejnë detyrat sipas standardeve edhe atëherë kur nuk kanë mbikëqyrje nga askush, sepse siç thotë Ai, pres që të jeni këmbëngulës dhe të përkushtuar në kryerjen e detyrave që ju jepen, të jeni shembull të ushtarëve profesionist. Për realizimin me sukses të programit të trajnimit bazik foli major Sami Hajrullahu, komandant i Qendrës së Stërvitjes Bazike në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, i cili tha se në këtë gjeneratë po diplomojnë 170 rekrutë, prej tyre 8 ushtare dhe 6 ushtarë, pjesëtarë të komu-





niteteve. Ai tha se kjo gjeneratë karakterizohet me përkushtim gjatë stërvitjeve si dhe rezultate të shkëlqyeshme. Në fund, major Hajrullahu tha se nëpërmjet këtij kursi është arrit përmbushja e objektivave të programit mësimor sa i përket aftësimit profesional të rekrutëve, përgatitjes fizike dhe psikike, si dhe hedhjes së bazave për karrierën e pjesëtarëve të rinj të FSK-së. Në fund, solemnisht u bë betimi i 170 rekrutëve të rinj, gjenerata e dytë 2015, të cilët do të shërbejnë në kuadër të gjitha njësiteve të FSK-së në Kosovë. Në ceremoni mori pjesë: ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli, zëvendësministri Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendëskomandanti i KFOR-it, kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Daut Haradinaj, si dhe anëtari i këtij komisioni Rexhep Selimi, përfaqësues nga Policia e Kosovës si dhe gjeneralë dhe ushtarakë të FSK-së, KFOR, oficerë të Ekipit Këshillues të NATO-s për MFSK-ë, të Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK (NLAT), atashetë ushtarakë të akreditуar në Prishtinë, kryetarë komunash, familjarë të rekrutëve dhe të ftuar të tjerë.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli priti në takim ambasadoren e Zvicrës, znj. Krystyna Marty Lang

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli, më 29 tetor, priti në takim, në mjediset e Ministrisë, ambasadoren e Konfederatës së Zvicrës në Republikën e Kosovës, Krystyna Marty Lang. Ministri Demolli fillimisht e falënderoi ambasadoren Lang për ndihmën që Qeveria e Zvicrës po jep për Kosovën dhe FSK-në, në veçanti për punën e ekspertëve ushtarakë të deminimit të cilët janë të angazhuar në pastrim të fushave të minuara në Kosovë, si dhe për kontributin madh të kontingjentit



të Ushtrisë së Zvicrës në kuadër të KFOR-it në Kosovë. Me këtë rast ai e njoftoi ambasadoren edhe për zhvillimet e përgjithshme në MFSK dhe FSK, me theks të veçantë me procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës. Ministri i FSK, z. Haki Demolli i shprehu ambasadores zvicerane interesimin për rritjen e kapaciteteve të FSK-së në të drejtën humanitare ndërkombëtare, si dhe sfera tjera që kanë të bëjnë me çështjet gjinore, gjithashtu në kuadër të këtyre edhe trajnimin dhe shkollimin e kuadrove të FSK-së në shtetin e Zvicrës. Nga ana e saj, ambasadorja zvicerane u shpreh jashtëzakonisht e kënaqur për pritjen që iu bë nga ministri Demolli, dhe po ashtu shfaqi kënaqësinë e saj për bashkëpunimin e deritashëm në mes dy shteteve dhe dy forcave. Ajo në fund premtoi vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

Ministria e FSK-së mbajti punëtorinë "Menaxhimi modern i burimeve njerëzore"

Në kuadër të projektit për mbështetje të burimeve njerëzore nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes së Norvegjisë, është mbajtur për dy ditë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 27- 28 tetor 2015, punëtoria; "Menaxhimi modern i burimeve njerëzore", në të cilën punëtori morën pjesë udhëheqësit e departamenteve dhe të njësive të MFSK-së. Në punimet e seminarit ishte i pranishëm edhe koloneli Goran Asarson nga Ekipi Këshillues i NATO-s (NAT). Gjatë mbajtjes së punëtorisë nga ekspertët e kësaj fushe u ligjëruan disa tema: Florian Qehaja nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)- udhëheqës i ekipit për Kosovë, kolonel Skënder Zhitia- udhëheqës i Departamentit të Personelit të MFSK-së, ligjëruan temën, Pse menaxhimi modern i burimeve njerëzore është i nevojshëm për administratën e tanishme publike, Damir Ahmetoviq ekspert rajonal, paraqiti temën; Menaxhimi modern i burimeve njerëzore, mjetet dhe praktikat dhe Ismet Mecinaj shef i Sektorit për Politika të Personelit, ligjëroi temën; Procedura dhe praktika e vlerësimit të performancës së stafit civil të MFSK-së. Në ditën e dytë, punëtorinë e vizitoi Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, drejtori i Drejtorisë për Operacione gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj drejtor i Departamentit për Operacione dhe Trajnime dhe drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane në MFSK, z. Faruk Geci. Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Sylaj, me këtë rast, ka përkrahur mbajtjen e kësaj punëtorie që është në interes të Ministrisë së FSK-së, si dhe ka kërkuar nga pjesëmarrësit që njohuritë e fituara t'i praktikojnë në departamentet e tyre. Interesimi i pjesëmarrjeve gjatë mbajtjes së punëtorisë ka qenë në nivel të lartë, kjo u dëshmua gjatë diskutimit praktik në grupe, ku të gjithë kontribuuan me diskutimet dhe komentet e tyre profesionale.



FSK-ja me sukses realizoi ushtrimin fushor "Shqiponja 4"

Presidentja Jahjaga vlerësoi lartë ushtrimin e FSK-së 'Shqiponja 4' që u zhvillua në Jezerc

Ministri Haki Demolli u shpreh i lumtur për realizimin me sukses të ushtrimit më të madh vjetor të FSK-së, si dhe përgëzoi gjeneral Rrahman Ramën për suksesin e FSK-së të treguar gjatë pesë ditëve të operacionit dhe falënderoi edhe këshilltarët ndërkombëtarë në kuadër të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT).



Presidentja e vendit Atifete Jahjaga, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandanti i KFOR-it, gjeneral major Francesco Paolo FIGLIUOLO, vizituan sot operacionet përfundimtare të ushtrimit fushor ,,Shqiponja 4" të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Jezerc të Ferizajt.

Me këtë rast, e para e vendit dhe njëherësh Komandantja e Përgjithshme, zonja Jahjaga pasi vizitoi nga afër demonstrimet e pjesëtarëve të njësive të specializuara në vend-incident, u shpreh tejet e lumtur me të arritur profesionale të njësive dhe të pjesëtarëve gjatë zhvillimit të operacioneve, me motivimin, disiplinën dhe përkushtimin për të realizuar detyrat sipas skenarit të paraparë për ushtrim. Presidentja përgëzoi ministrin Demolli dhe komandantin e FSK-së gjeneral Ramën për realizimin me sukses të këtij ushtrimi, me të cilin siç tha ajo janë provuar dhe demonstruar shkathtësitë reaguese të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për të qenë e gatshme për intervenim kurdo që kërkohet në situata reale. Në fund presidentja e vendit tha se ky përkushtim i këtyre djemve dhe vajzave, ky seriozitet dhe ky përparim është treguesi më i mirë që FSK-ja është e gatshme për t'u transformuar në Forca të Armatosura të Kosovës, më çka do të kompletohej infrastruktura e sigurisë në vend.



Pas vizitës që ministri Haki Demolli u bëri katër vend-incidenteve gjatë operacioneve të ushtrimit ,, Shqiponja 4", u shpreh i lumtur për realizimin me sukses të ushtrimit më të madh vjetor të FSK-së, si dhe përgëzoi gjeneral Rrahman Ramën për suksesin e FSK-së të treguar gjatë pesë ditëve të operacionit. Gjithashtu, ministri falënderoi edhe këshilltarët ndërkombëtarë në kuadër të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s(NLAT). Në fund Ministri Demolli tha se MFSK-ja dhe FSK-ja janë duke vepruar aktualisht në kuadër të misionit, ndërsa procesi i transformimit, tha ai, do të jetë plotësisht transparent dhe do të bëhet në koordinim me partnerët tanë strategjik, si ShBA-të, Bashkimi Evropian dhe NATO.



Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama u shpreh tejet i lumtur me demonstrimet gjatë ushtrimit të sotëm. Më tej komandant Rama tha se ,,Ne kemi arrit synimin dhe qëllimin tonë e gjithashtu pas analizës dhe nxjerrjes së mësimeve të mësuara do t'i masim rezultatet, por në bazë të kësaj çka ne të gjithë pamë sot, unë jam i kënaqur që jam komandanti kësaj Force. Skenari i ushtrimit ishte reagimi i FSK-së në ndihmë autoriteteve lokale pas një tërmeti në rajonin e Ferizajt dhe kërcimet që dalin nga tërmeti si: fatkeqësi natyrore, dëmtim të infrastrukturës, lëvizje të popullatës dhe daljen në skenë të organizatave kriminale si pasojë. Për këtë qëllim FSK-ja angazhoi njësitë e specializuara të Mbrojtjes Kimike Atomike Biologjike, të Deminimit dhe Eliminimit të Mjeteve të Pashpërthyera, Njësinë e Mjekësisë, Kërkim-Shpëtimin Urban si dhe Brigadën për Reagim të Shpejtë.

Objektiv i ushtrimit fushor ,, Shqiponja 4" ishte trajnimi i liderëve dhe njësive për Detyrat Kolektive, me qëllim të realizimit të operacioneve komplekse, në mbështetje të autoriteteve civile në fazën e Planifikimit, Ekzekutimit si dhe atë të Analizimit.

Gjithashtu objektiv tjetër ishte edhe që të mbahet niveli i gatishmërisë operacionale dhe të zhvillohen aftësitë ekzistuese, përmirësimi i koordinimit me institucionet e tjera të sigurisë në operacion, dislokimi i forcave nga vend-bazimi i përhershëm në zonën e operacionit dhe zbatimi i sistemit të mësimeve të mësuara. Njësitë e FSK-së gjatë ushtrimit fushor i vizituan edhe ambasadorët e SHBA-ve, Shqipërisë, Turqisë, pastaj atashetë ushtarakë të vendeve partnere, gjithashtu edhe kryetarët e komunave Ferizaj dhe Suharekë si dhe oficerë nga Policia e Kosovës dhe personalitete vendore dhe ndërkombëtare. Në ushtrimi fushor „Shqiponja 4"të Forcë së Sigurisë së Kosovës i cili u zhvillua nga data 11 deri më 16 tetor 2015 në lokacionin e Jezercit, Komuna e Ferizajt, ishin të angazhuar rreth 400 trupa me rreth 65 automjete.



Në Kampin Bonstell të KFOR-it amerikan

FSK-ja dhe KFOR-i amerikan me një aksion të përbashkët shkatërrojnë mbi 40 mjete të pashpërthyera




Ekipi i Kompanisë së Deminimit të FSK-së së bashku me Ekipin e EOD-së të KFOR-it amerikan, më 30 tetor 2015, në Kampin Bonstell, kanë shkatërruar rreth 40 mjete të pashpërthyera, kasetë bomba, të gjetura në Parkun "Liria" dhe në territorin e Kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Mjetet e shkatërruara janë kryesisht mjete që kanë mbetur nga lufta e dytë botërore. Me këtë rast, komandanti i Kompanisë së Deminimit të FSK-së, kapiten Sejdi Krasniqi tha se ekipet e deminimit të FSK-së, janë njësi të specializuara të cilët me sukses po pastrojnë kudo në Kosovë fushat e mbetura nga mjete të pashpërthyera nga lufta e fundit në Kosovë. Mirëpo, mjetet e gjetura në Parkun Liria dhe në territorin e Kazermës së FSK-së, kapiten Krasniqi tha se janë duke i shkatërruar në një operacion të përbashkët me ekipet e KFOR-it, respektivisht me ekipin e OED-së të kampit Bondsteel në Ferizaj. Ne falënderojmë KFOR-in amerikan për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm si dhe ndihmën profesionale e materiale që po japin Kompanisë së deminimit të FSK-së, tha në fund kapiten Sejdi Krasniqi. Ndërsa, Wayne Brown, rreshter i parë i njësitit 666 për shkatërrimin e mjeteve të pashpërthyera eksplozive me grupin shumëkombësh të betejës lindje në KFOR-in amerikan, tha se janë të lumtur që po bashkëpunojnë me FSK-në në demolimin e mjeteve të pashpërthyera. "Këtu jemi duke e bërë një operacion të përbashkët të demolimit, së bashku me Forcën e Sigurisë së Kosovës duke demoluar mjetet e pashpërthyera. Jemi shumë të kënaqur që kemi FSK-në këtu, që janë bashkë me ne duke bërë operacione të përbashkëta, dhe dëshirojmë që të vazhdojmë këtë bashkëpunim sa më gjatë që mundemi", tha BroWn. Mjetet e pashpërthyera që janë gjetur nga ekipet e deminimit të FSK-së, janë bërë brenda zonës së kampit Bondsteel. Ndërsa, FSK dhe KFOR-i amerikan shprehen gatishmërinë që edhe në të ardhmen të bashkëpunojnë në shkatërrimin e mjeteve të pashpërthyera.

FSK-ja e para në garën ushtarake "SYNCON 31 CHALLENGE" organizuar nga KFOR-i Sllovenë

Në bazën ushtarake të KFOR-it "Village Italia" në Pejë, më 10 tetor, nën organizimin e kontingjentit të KFOR-it sllloven, është mbajtur gara tradicionale ushtarake "SYNCON 31 CHALLENGE", në të cilën morën pjesë 14 ekipe ushtarake; shtatë prej tyre ishin nga shtetet anëtare të NATO-s, si: SHBA, Italia, Sllovenia, Polonia, Portugalia, Austria, ekipe nga EULEX-i, kurse FSK-në e përfaqësoi ekipi i Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, me ftesë të KFOR-it sllloven. Qëllimi i mbajtjes së kësaj gare, mjaft sfiduese, ishte ngritja e aftësisë profesionale në aspektin individual dhe atë ekipor-kolektiv. Ekipet pjesëmarrëse në garë është dashtë t'i kalojnë shumë disiplina, si: poligonin luftarak, navigimin, marshimin sfidues, qitje me armë, evakuim tëi viktimave dhe tërheqje të automjetit me litar. Ekipi i FSK-së në të gjitha stacionet trajnuese ka treguar rezultate të shkëlqyeshme, duke dalë fitues në çdo disiplinë. Nga organizatorët është vlerësuar lartë performanca e ekipit të FSK-së, të cilët kanë punuar si trupë e përbashkët dhe falë këtij angazhimi kanë arritur rezultate të larta në të gjitha disiplinat. Në ceremoninë përmbyllëse mori pjesë edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i cili vlerësoi lartë organizimin e këtij gare, si dhe përgëzoi ekipin e FSK-së duke shprehur gatishmërinë dhe angazhimin e tij për përkrahjen dhe mbështetjen e pakursyer në çdo organizim të tillë. Gjeneral Hazrolli falënderoi edhe komandantin e kontingjentit ushtarak të KFOR-it sllloven, nënkolonelin Boštjan Mo?nik dhe komandantin e kampit "Village Italia", kolonelin Ciro Forte, për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshëm që vendi i tij është duke dhënë për FSK-në. Ndërsa, nënkoloneli Boštjan Mo?nik përgëzoi ekipin e FSK-së për paraqitjen e shkëlqyeshme dhe angazhimin ekipor dhe individual. Kjo garë organizohet çdo vit nga KFOR-i dhe ka karakter sfidues. Këtë vit, me ftesë të KFOR-it sllloven, në këtë garë mori pjesë edhe një ekip i Forcës së Sigurisë së Kosovës.





Ministri i FSK-së Haki Demolli çmoi lartë angazhimin e Sllovenisë për FSK-në



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli, më 28 tetor 2015, priti në një takim lamtumirës këshilltarin ushtarak slloven për operacione dhe trajnime në kuadër të Ekipit këshillues të NATO-s për MFSK-në, nënkolonel Miroslav Galun, i cili përfundoi misionin e tij në Kosovë. Me këtë rast, ministri Demolli në shenjë falënderimi për bashkëpunimin, koordinimin dhe forcimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve në mes të dy ministrive; Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë, i dhuroi këshilltarit slloven një Certifikatë Falënderimi, me anë të së cilës ai shprehu mirënjohjen e tij për gjithë angazhimin dhe kontributin e dhënë në kuadër të NAT-it. Ndërsa, nënkoloneli Miroslav Galun falënderoi ministrin Demolli dhe FSK-në për bashkëpunimin dhe kultivimin e raportit shumë frytdhënës gjatë gjithë kohës se shërbimit të tij në FSK.

Komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci takoi ambasadorin e Britanisë së Madhe Rauiro O'Connell



Kazermën e FSK-së "Ushtarët e NATO-s" në Istog, më 7 tetor e vizitoi ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, z. Ruairí O'Connell. Ai u prit nga komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, i cili e njoftoi ambasadorin O'Conell me të arriturat e BRSH-së, me trajnimet dhe bashkëpunimin me këshilltarët ushtarak të Britanisë se Madhe të cilët janë angazhuar në trajnimin "Operacionet e Mbështetjes për Paqe" të pjesëtarëve të BRSH-së. Brigada për Reagim të Shpejtë e FSK-së, nga data 14. 09. 2015, ka filluar realizimin e trajnimit "Operacionet e Mbështetjes së Paqes" me ekipin e Ushtrisë së Britanisë për këshillim dhe trajnim, ku nga instruktorët e këtij ekipi janë ligjëruar dhe praktikuar tema të rëndësishme për zhvillimin e pjesëtarëve të BRSH-së. Ky trajnim ka për qëllim ngritjen dhe zhvillimin profesional të pjesëtarëve të BRSH-së, për detyrat që mund të caktohen nga komanda madhore e që ndërlidhen me misionin aktual dhe misionin në të ardhmen. Trajnimin e përcolli edhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, z. Ruairí O'Connell, i cili falënderoi kolonel Gecin për pritjen, informimin dhe njëherësh e përgëzoi për të arriturat e BRSH-së. "Jam shumë i kënaqur që po informohem nga afër me të arriturat e FSK-së, si institucioni me i besueshëm në vend, dhe po ashtu jam impresionuar edhe me të arriturat e BRSH-së. Ne do të vazhdojmë edhe në të ardhmen ta mbështesim Kosovën e sidomos FSK-në. Kjo nuk është e vështirë duke marrë parasysh se FSK punon në bazë të standardeve të NATO-s"-shtoi në fund ambasadori Ruairí O'Connell.

Gjenerali Stefan Fix vizitoi Brigadën për Reagim të Shpejtë të FSK-së

Komandanti i BRSh-së, kolonel Xhevahir Geci priti në një vizitë pune drejtorin e NLAT-it, gjeneral brigade Stefan Fix me bashkëpunëtorë. Me këtë rast, kolonel Geci e falënderoi gjeneralin Fix për vizitën si dhe e njoftoi me aktivitetin e përgjithshëm të Brigadës për Reagim të Shpejtë, me të arriturat si dhe trajnimet brenda dhe jashtë vendit. Ndërsa, shefi i Shtabit të BRSh-së, major Ejup Maqedonci përmes një prezantimi e njoftoi gjeneralin Fix, lidhur me misionin, strukturën, trajnimet, detyrat, operacionet, planifikimin dhe sfidat, fokusuar në konceptin e gjenerimit të forcës të BRSH-së. Drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Stefan Fix, gjatë qëndrimit në BRSh, vizitoi sektorët e saj dhe Batalionin e



Dytë të BRSh-së, ku u njoftua për se afërmi me punën dhe detyrat që realizon BRSh-ja. Gjenerali Fix e falënderoi kolonelin Geci dhe stafin e tij për pritjen dhe informimin lidhur me të arriturat e BRSh-së, dhe e përgëzoi për paraqitjen e mirë të pjesëtarëve të BRSh-së gjatë ushtrimeve dhe trajnimeve të përgjithshme.

FSK-ja dhe kontingjenti ushtarak i Bondstillit i dhuruan donacion Mjekësisë Familjare në Klinë



Departamenti për Bashkëpunim Civil-Ushtarak (DBCU) i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) në bashkëpunim me Zyrën Mbështetëse Civile-Ushtarake të Ambasadës Amerikane në Prishtinë, më 27 tetor 2015, i dhuruan një donacion me medikamente dhe pajisje mjekësore, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytetin e Klinës. Dorëzimin e donacionit e bëri nënkolonel Afrim Veseli, shef i Sektorit për Bashkëpunim me Agjencitë në kuadër të Departamentit për Bashkëpunim Civilo - Ushtarak të Ministrisë, i cili edhe shprehu kënaqësinë që bashkëpunimet e tilla sjellin fryte të cilat janë të mirëseardhura për qytetarët, sidomos kur është fjala për pajisje mjekësore dhe medikamente. Nënkolonel Veseli falënderoi Zyrën Civilo - Ushtarake të Ambasadës Amerikane dhe kontingjentin amerikan nga Bonstilli, të cilët ndanë këtë donacion për popullatën e Klinës me rrethinë, si dhe ndikuan që fondi me këto medikamente dhe pajisje mjekësore të jetë më i pasur, në mënyrë që shërbimet mjekësore të ofrohen më me lehtësi për qytetarët në nevojë. Nga pala amerikane donacionin e dorëzoi kolonel Vineent Valinoti, komandant i Task Forcës Medicinale në Kampin e Bonstillit, ndërsa e pranoi drejtori për Shëndetësi dhe Politika Sociale, Bedri Gashi dhe drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinë, Ali Ahmetgjekaj. Vlen të theksohet se Departamenti për Marrëdhënie Civilo - Ushtarake i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Zyra për Mbështetje Civilo-Ushtarake e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, kanë një bashkëpunim të shkëlqyeshëm, fryt i së cilës është edhe donacioni për Komunën e Klinës.

Pjesëtarë të BRSh-së u certifikuan si trajner për reagues të parë





Në kazermën ,,Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSh) në Istog, më 22 tetor 2015, u zhvillua ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të cilët kanë vijuar trajnimin ,,Trajno trajnerët" për trajnerë ,,Reaguesi i parë në vendngjarje". Trajnimi u organizua nga ekipi ushtarak i trajnerëve nga Mbretëria e Bashkuar me kontributin e Zyrës së atasheut të Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar dhe zgjati dhjetë ditë. Në fjalimin e tij drejtuar të pranishmëve, ushtruesi i detyrës së komandantit të BRSh-së, kolonel Xhevahir Geci theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm që ka FSK-ja me Britaninë e Madhe dhe Irlandën e Veriut, dhe kontributin që këta të fundit kanë dhënë në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, në trajnime të tilla dhe të tjera. Gjithashtu, kolonel Geci shprehu falënderime për ekipin e instruktorëve, për punën dhe përpjekjet e vazhdueshme të tyre për të kontribuar në zhvillimin e FSK-së. Drejtori i kursit, David Derbyshire nga Ekipi Trajnues i Britanisë së Madhe theksoi se: " Ka qenë kënaqësi të vazhdojmë me realizimin e trajnimeve në FSK, sidomos me realizimin e trajnimit të fundit në BRSh, "Trajno Trajnerët", ku pjesëtarët e BRSh-së gjatë gjithë periudhës së realizimit të trajnimit kanë shfaq përkushtim dhe profesionalizëm të shkëlqyer". Në fund, drejtori i Departamentit të Mjekësisë në MFSK, kolonel Xhevdet Tahiraj pasi falënderoi pjesëmarrësit dhe instruktorët në emër të komandantit të FSK-së tha se pas përfundimit me sukses të këtij trajnimi dhe menjëherë që nga sot, këta pjesëtarë do të jenë ata të cilët do të trajnojnë pjesëtarët e tjerë të FSK-së për reagim të parë në vendngjarje pas ndonjë aksidenti apo çfarëdo fatkeqësie tjetër. Gjatë trajnimit të gjithë pjesëmarrësit kanë përfunduar me sukses testimin dhe janë certifikuar si trajner për trajnimin e pjesëtarëve "Personi i Parë në Vendngjarje". Me këtë rast, ekipi trajnues nga Britania e Madhe, pjesëtarëve të certifikuar u ka dhuruar nga një pako profesionale për ndihmë të parë. Në ceremoni, gjithashtu, ishin të pranishëm edhe ushtruesi i detyrës së shefit të Shtabit të BRSh-së major Ejup Maqedonci dhe rreshter majori i parë i FSK-së Genc Metaj.

Certifikohen pjesëtarët e Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së

Në kazermën ,,Ushtarët e NATO-s" të FSK-së në Istog, më 8 tetor, u mbajt ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve të BRSH-së, të cilët për një muaj ndoqën trajnimin ,,Operacionet e Mbështetjes së Paqes" zhvilluar nga ekipi i instruktorëve të Ushtrisë së Britanisë. Me këtë rast, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli përgëzoi pjesëtarët e BRSH-së dhe instruktorët e BMAT për realizimin me sukses të këtij trajnimi, duke kërkuar që njohuritë e fituara të mirëmbahen dhe forcohen në vazhdimësi. Komandanti i BRSH-së, Kolonel Xhevahir Geci, tha: "Trajnimi Operacionet e Mbështetjes së Paqes" është i mirëseardhura për zhvillimin dhe profesionalizimin e pjesëtarëve të BRSH-së, duke marrë parasysh natyrën dhe temat e trajnimit të cilat përputhen me misionin aktual të BRSH-së dhe me synimin tonë për të qenë pjesë e Operacioneve të Mbështetjes së Paqes në të ardhmen". Ndërsa, komandanti i BMAT-it, kolonel David Catmor pasi përshëndeti pjesëmarrësit dhe instruktorët për angazhimin dhe punën profesionale, shtoi: "Në bazë të raportimeve nga instruktorët e BMAT-it, jam shumë i kënaqur me angazhimin dhe performancën e pjesëtarëve të BRSH-së të cilët patën një paraqitje të shkëlqyer dhe njëkohësisht ishin shumë të interesuar të trajnohen në mënyre profesionale". Gjatë këtij trajnimi, pjesëtarët e BRSH-së janë pajisur me njohuri të reja teorike dhe praktike në fusha të ndryshme, duke u fokusuar në ngritjen dhe profesionalizimin e tyre në kryerjen e detyrave taktike, për realizimin sa më të mirë të misionit dhe synimit për të qenë pjesë e Operacioneve të Mbështetjes së Paqes në të ardhmen. Në këtë ceremoni morën pjesë edhe pjesëtarë të tjerë të FSK-së dhe ushtrisë së Britanisë së Madhe.



Pjesëtarët e Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë ndihmojnë qytetarët e aksidentuar



Pjesëtarët e Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, më 21 tetor 2015, kanë arritur të ofrojnë ndihmën e parë në vendngjarje qytetarëve, të cilët ishin pasagjer të automjeteve të përfshira në aksidentin automobilistik të ndodhur më datë 20 tetor rreth orës 16:00 në rrugën Istog-Rakosh, saktësisht ndërmjet kazermës së FSK-së dhe Burgut të Dubravës. Pjesëtarët e FSK-së, të cilët sapo kishin përfunduar orarin e punës në kazermën e FSK-së, rrugës kanë hasur në aksidentin e ndodhur në mes të dy veturave civile në të cilin ishin lënduar 6 persona(3 fëmijë dhe dy prindërit e tyre dhe shoferi i veturës tjetër të përfshirë në aksident).Pjesëtarët tanë kanë arritur që të gjithë të lënduarve t'u ofrojnë ndihmën e parë mjekësore në vendngjarje, si dhe t'i transportojnë sigurt me automjetet e tyre deri në Shtëpinë e Shëndetit në Istog. Vlen të theksohet se pjesëtarët e FSK-së janë mjaft të përgatitur për ofrimin e ndihmës së parë, dhe se, në raste kur atyre ju kërkohet janë të gatshëm të ndërhyjnë dhe të japin kontributin e tyre në shpëtimin e jetës së personave në nevojë. Gatishmëria, vetëmohimi, si dhe motivimi i pjesëtarëve tanë për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve ka bërë që pasojat e rastit në fjalë të jenë shumë vogla, dhe se, 6 personat e aksidentuar ta marrin ndihmën e parë mjekësore në kohë shumë të shpejtë, e gjithashtu edhe trajtimin mjekësor të mëtutjeshëm në institucionet shëndetësore.

FSK-ja në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë

Shefi i Sektorit për Bashkëpunim me Institucionet, nënkolonel Afrim Veseli, me ftesë të shoqatës joqeveritare ,,Drita jonë", më 19 tetor, mori pjesë në marshin simbolik të organizuar për nderë të shënimin të Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë në Vushtrri.
Pas marshimit, me një fjalë rasti të pranishmëve u është drejtuar edhe nënkolonel Veseli i cili përshëndeti këtë aktivitet në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës si dhe falënderoi kryetaren e shoqatës joqeveritare ,,Drita Jonë", znj. Sevdije Voca.
Në këtë marsh simbolik, përveç oficerit të FSK-së morën pjesë edhe zyrtarë komunalë të Vushtrrisë, oficerë nga Policia e Kosovës si dhe të ftuar të tjerë.



Përfundoi me sukses aktiviteti sportiv humanitar “Vrapo me FSK-në- Gjakova 2015”

Në qytetin e Gjakovës, Forca e Sigurisë së Kosovës së bashku me Komunën e Gjakovës, më 5 tetor, organizuan manifestimin sportiv në atletikë, me moton "Vrapo me FSK-në- Gjakova 2015", me qëllimin më të mirë, për t'iu dalë në ndihmë fëmijëve me nevojë të kësaj komune. Në shtegun 10 kilometra të gjatë vrapuan qindra pjesëtarë të FSK-së, KFOR-it, shoqërive joqeveritare, qytetarë të Kosovës etj. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama pasi përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit, tha se ideja dhe qëllimi i organizimit të këtij evenimenti sportiv humanitar është që t'u ndihmojmë fëmijët në nevojë. Ky është vetëm fillimi. Ne do të vazhdojmë me organizime të tilla. FSK-ja është e gjithë qytetarëve dhe ne, gjithnjë do të jemi pranë tyre, me të gjitha mundësitë dhe kapacitet që kemi",- shtoi në fund gjeneral Rama. Gjithashtu, pjesëmarrësit i përshëndeti edhe e para e Komunës së Gjakovës, znj. Mimoza Kusari-Lila, e cila uroi të gjithë pjesëmarrësit. Në kategorinë e meshkujve vendin e parë e zuri, Emin Greicevci nga klubi i atletikës në Fushë-Kosovë,








vendin e dytë Radman Risto nga KFOR-i dhe vendin e tretë Kushtrim Kelmendi.
Ndërsa, në kategorinë e femrave vendin e parë e zuri Fjolla Margata nga klubi i atletikës në Prishtinë, vendin e dytë Witoma Katrin nga EULEX-i dhe vendin e tretë Qëndresa Ramadani. Shtegun me sukses e kaloi edhe zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli. Në këtë vrapim ka marrë pjesë edhe kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila, e cila është shprehur e kënaqur jo vetëm me organizimin, por edhe me interesimin e pjesëmarrësve. Mjetet e përfituara nga manifestimi sportiv "Vrapo me FSK-në- Gjakova 2015", do të ndahen për fëmijët në nevojë të Komunës së Gjakovës. Në fund të këtij manifestimi, për tri vendet e para u ndanë medalje nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari Lilaj. Ky ishte një organizimin shembullor i FSK-së së bashku me Komunën e Gjakovës. Edhe kësaj radhe FSK-ja dëshmoi se është afër qytetarëve të saj, ashtu si edhe në të ardhmen do të jetë afër tyre, për t'i ndihmuar të gjithë ata që kanë nevojë. Mbylljen e manifestimit e bëri kryetarja e Gjakovës e cila falënderoi FSK-në, Policinë e Kosovës dhe qytetarët e Gjakovës.

Me sportist të dalluar të FSK-së

Ushtarja e FSK-së Gentianë Ismaili kampione në basketboll me Sigal Prishtinën



Gentiana Ismaili është njëra ndër basketbollistet më të mira në Kosovës, e cila po luan me sukses për klubin e basketbollit "Sigal Prishtina" nga Prishtina, me të cilin ka fituar tri herë radhazi titullin e Kampionatit të Kosovës. Federata e Basketbollit të Kosovës, gjatë vitit 2013/2014, shpalli si lojtaren më të mirë në Kosovë, playmakerja (organizatorja e lojës Gentianë Ismaili është ushtare e Forcës së Sigurisë së Kosovës e sistemuar në Batalionin e Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Gjilan. Ajo është ushtare e dalluar dhe është bërë shembull për kryerjen e detyrave ushtarake me sukses. Dëshira për lojën magjike të basketbollit i lindi qysh si nxënëse e shkollës fillore, ku edhe filloi ushtrimet në shkollën e basketbollit për femra në Gjilan. Fillimisht ka luajtur për klubin basketbollit "Drita" nga Gjilani, për senior, dhe për klube tjera, si: KB "Bashkimi", nga Prizreni, KB "Kastrioti" nga Ferizaj dhe ka katër vjet që luan për KB "Sigal Prishtina" me të cilën ka arrit sukseset më të mira, tri herë radhazi ka fituar titullin e kampionatit në Kosovë. Gjatë një intervistë për gazetën "Forca Jonë" Gentiana



shpalos eksperiencën e saj dymbëdhjetëvjeçare në fushën e basketbollit, dëshirën për të luajtur basketboll, sakrificën dhe të arriturat e saj, gjatë kësaj periudhe kohore. Ajo është shumë modeste kur fletë për të arriturat personale, sepse sukseset ua dedikon kolegeve dhe klubit. " Gjatë kësaj periudhe kemi treguar rezultate mjaft të mira, ku jam shpërblyer me disa çmime: në kategori të kadetëve (kampione e një turneu kadetësh) jam shpallur lojtarja më e mirë, kurse me klubin Sigal Prishtina kemi arritur që tri herë radhazi të fitojmë titullin e kampionit nga Federata e Basketbollit të Kosovës, gjatë vitit 2011- 2012 jam shpallur ndër 10 basketbollistët më të mira në Kosovë, ndërsa gjatë viteve 2013-2014 playmakerja (organizatorja e lojës) më e mirë në Kosovë ". Gentiana Ismaili si ushtare e Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së në Gjilan, tregon se ndjehet mjaft e kënaqur me jetën ushtarake, e donë uniformën e FSK-së, gjë të cilën e dëshmon në praktikë me angazhimin dhe punën e pakursyer. Ajo shpreson që në të ardhmen të arrij një karrierë të lartë ushtarake, por gjithmonë pa lënë anash as basketbollin i cili tanimë është bërë pjesë e pandashme e jetë së saj. Ajo vazhdon të luaj me sukses për klubin e basketbollit "Sigal Prishtina", me të cilën ka arritur suksese kulmore. Dëshirë e saja është që, në të ardhmen, klubi ku ajo luan të tregojë kualitete të larta edhe në garat ndërkombëtare , Ajo shpreson se e ardhmja e basketbollit në Kosovë, falë talenteve të shumta, është e ndritshme. Ndërsa sa i përket sukseseve të arritura deri me tani, ajo thotë se janë falë harmonisë, raporteve të mira dhe punës profesionale që bëhet në klubin e basketbollit "Sigal Prishtina".

FORCA JONË

□□□ Viti IV □ Nr. 41 □Dhjetor 2015 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Ministri Haki Demolli në "Konferencën e Rigës" në Letoni

Ministria e Forcës së Sigurisë merr përkrahjen e Letonisë për anëtarësim në NATO

Ministria e Mbrojtjes së Letonisë do ta ndihmojë MFSK-në dhe FSK-në në aspektin e procesit të transformimit, si dhe në aspektin afatgjatë të anëtarësimit të Kosovës në NATO dhe BE. Këtë përkrahje e mori ministri i FSK-së, HakiDemolli gjatë qëndrimit në Letoni, ku me ftesë të Ministrit të Mbrojtjes së këtij vendi, ministri Demolli i shoqëruar edhe nga drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, FarukGeci, si dhe atasheu i ushtarak i Kosovës në Belgjikë, kolonel Ahmet Ajeti po qëndrojnë në konferencën e 10 të sigurisë "Konferenca e Rigës" (Riga Confrence). Gjatë ditës së djeshme, ministri Demolli me bashkëpunëtorë ka pasur takim të veçantë me ministrin e Mbrojtjes së Letonisë, RaimondsBergmanis, me të cilin



ka diskutuar për mbështetjen e mëtejme të Letonisë me këshilltarë në kuadër të ekipit këshillues të NATO-s, por edhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit mbi bazën e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar më herët në mes të dy ministrive përkatëse. Me këtë rast është kërkuar që grupet punuese të krijojnë një plan konkret të bashkëpunimit, me ato aktivitete që të mund të nënshkruhet në vizitën e radhës të ministrit të Mbrojtjes së Letonisë në Kosovë, me qëllim që ky plan bashkëpunimi të realizohet gjatë vitit 216.Po ashtu, ministri Bergmanis u angazhua që Ministria e Mbrojtjes së Letonisë të ndihmojë MFSK-në dhe FSK-në në aspektin e procesit të transformimit, sidomos në aspektin e funksionalizimit të strukturës së ardhshme të Ministrisë dhe Forcës, si dhe në aspektin afatgjatë të anëtarësimit të Kosovës në NATO dhe BE. Në sesionet e rregullta të konferencës është duke u diskutuar për çështje të rëndësishme si: ngritja gjeo-ekonomike, NATO në mbrojtjen e stabilitetit global, QUO VADIS Rusi në shekullin 21, përgjigja në gjeneratën e re të luftës, e ardhmja evropiane dhe çështje tjera. Në këtë konferencë po marrin pjesë Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes se Letonisë, Kryeministri i Ukrainës, Zëvendëspresidenti i Komisionit Evropian, ambasadorë të vendeve të ndryshme, ushtarakë dhe ekspertëtë fushës së mbrojtjes dhe sigurisë.

Ministri Haki Demolli mori pjesë në Konferencën e Sigurisë në Halifaks të Kanadasë



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli me ftesë të Forumit Ndërkombëtar të Halifaksit për Siguri, mori pjesë në punimet e konferencës "Avancimi i sigurisë nga vizioni modern", e cila u zhvillua në Halifaks të Kanadasë nga data 20-22 nëntor 2015. Ministri i FSK-së, Haki Demolli në punimet e konferencës në Halifaks foli për perspektivën aktuale të Kosovës në sfidat më të ngutshme të sigurisë, duke bërë që tema të zgjojë interesim të madh tek audienca e gjerë pjesëmarrëse në konferencë. Ministri Demolli ndër të tjera u fokusua edhe tek sfidat me të cilat po ballafaqohet rajoni dhe ri-konfirmoi se rruga e vetme për rajonin është përshpejtimi i integrimeve euro-atlantike të vendeve të Ballkanit. Ministri Demolli zhvilloi edhe një varg takimesh në nivel dypalësh dhe shumëpalësh me disa prej ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s pjesëmarrëse në konferencë e gjithashtu edhe me disa prej ministrave të vendeve partnerë të NATO-s. Ministrit Demolli u takua në Halifaks edhe me zëvendëssekretarin e Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Robert Work, pastaj me Ministrin e Mbrojtjes së Kanadasë, Harjit Sajjan, si dhe atë të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Maqedonisë. Në takime u diskutuansfidat dhe rreziqet që mund të vijnë, si dhe nevoja që bashkërisht dhe njëzëri të unifikohen qëndrimet e botës demokratike dhe përmes bashkëpunimit gjithëpërfshirës të ballafaqohemi me rreziqet e ashtuquajtura bashkëkohore.Ministri i FSK-së, Haki Demolli zhvilloi një takim kokë me kokë me shkëlqesinë e tij, ministrin e Mbrojtjes së Kanadasë, Harjit Sajjan. Ministri e falënderoi me këtë rast shtetin e Kanadasë për gjithë ndihmën dhe kontributin e dhënë për popullin dhe shtetin e Kosovës. Po ashtu ministri Demolli e falënderoi ministrin Sijjan për përkrahjen e vazhdueshme që vendi i tij i ka ofruar Republikës së Kosovës në rrugën e saj të pakthyeshme euro-atlantike. Ai me theks të veçantë foli edhe për kontributin e madh të kontingjentit kanadez në kuadër të KFOR-it si dhe ekipit këshilluese në MFSK dhe FSK. Ministri Demolli në takim e ngriti idenë për një marrëveshje dypalëshe në mes MFSK-së dhe Departamentit Nacional Kanadez të Mbrojtjes në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Po ashtu Ministri Demolli ftoi ministrin kanadez për një vizite në Republikën e Kosovës. Ministri Sajjan ri-konfirmoi edhe një herë se kontributi dhe përkrahja e Kanadasë nuk do të mungojë për Republikën e Kosovës dhe se do të shqyrtohen mundësitë dhe rrugët e bashkëpunimit dypalësh në një të ardhme të afërt. Ministri Demolli në Forumin e Halifaksitishte i shoqëruar edhe nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Kanada, LulzimHiseni si dhe Sinan Geci, shef i Sektorit për Bashkëpunim Euro- Atlantik në MFSK. Forumi Ndërkombëtarë për Siguri në Halifaks është i njohur si një vend- takim vjetor i cili krijon hapësirë ku vendimmarrësit bashkërisht mund të zgjidhin çështje të vështira. Tani në kohën kur vendet demokratike po ballafaqohen me kërcënime kjo është shumë urgjente sepse asnjë vend veç e veç nuk mund t'i zgjidhë problemet e vetme, ashtu siç mund ta bëjnë liderët e mençur së bashku.

Komandanti i FSK-së u prit në Shkup nga shefi i Shtabit të Armatës së Maqedonisë



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, u takua në Shkup me shefin e Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë, gjeneral nënkolonel, Metodija Veliçkovski. Komandanti i FSK-së u prit nga Garda Ceremoniale e Ushtrisë së Maqedonisë, ku zhvilloi një takim kokë me kokë me shefin e shtabit. Ata u pajtuan që bashkëpunimi në mes dy vendeve, përkatësisht dy forcave të armatosura të vazhdojë edhe më tutje, duke u rritur veçmas në fushë e trajnimeve, arsimimit, mjekësisë si dhe pjesëmarrjes në iniciativa rajonale. Gjeneral Rama dhe gjeneral Veliçkovski diskutuan edhe një varg çështjesh lidhur me fushëveprimin në bazë të marrëveshjes dypalëshe të nënshkruar kohë më parë ndërmjet dy institucioneve dhe dyja shteteve. Gjeneral Rama vlerësoi lartë angazhimin e Akademisë së Mbrojtjes të Maqedonisë e cila po shkollon kadetët tanë. Gjithashtu, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pas takimit, në konferencën e mbajtur për shtyp, tha se synimi ynë është që FSK-ja të jetë pjesë e të gjitha iniciativave rajonale, duke kërkuar kështu edhe përkrahjen e Maqedonisë në këtë drejtim. Më tej komandanti i FSK-së shprehu edhe një herë gatishmërinë për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave me shtetin maqedonas. Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë, Metodija Veliçkovski, shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejme me FSK-në, sidomos në fushën e sigurisë. "Jemi të gatshëm ta mbështesim FSK-në në fushën e arsimimit duke iu ofruar mundësi shkollimi kadetëve të saj në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë, apo duke iu ofruar trajnime pjesëtarëve të FSK-së në Poligonin tonë Ushtarak, si dhe pjesëmarrjen e tyre në trajnime të përbashkëta rajonale"- përfundoi shefi i Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë, gjeneral nënkolonel, Metodija Veliçkovski. Komandanti i FSK-së, u prit edhe nga zëvendësministri i Mbrojtës së Maqedonisë, Ilmi Selami, dhe zëvendës shef i shtabit gjeneral major Muhamet Racaj. Gjatë vizitës së tij në Maqedoni, gjeneral Rama vizitoi edhe Akademinë e Mbrojtës dhe Qendrën e Trajnimit për pilot në Petrovec.

Shefi i Gardës Kombëtare të ShBA-së Gjenerali Frank Gras vizitoi Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli me bashkëpunëtorë, priti në vizitë zyrtare një delegacion të lartë të Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës(ShBA), të prirë nga shefi i Gardës Kombëtare të ShBA-së, gjeneral Frank. J. Gras. Në takimin e përbashkët të delegacioneve, ministri i FSK-së z. Demolli shprehu kënaqësinë që sot në Ministri ka për vizitë mbështetës dhe miq të sinqertë të Ministrisë, FSK-së dhe Kosovës. Fillimisht, Ministri Demolli e falënderoi gjeneralin Grass për bashkëpunimin dhe mbështetjen që ShBA-ja është duke i ofruar FSK-së në të gjitha drejtimet me qëllim të ngritjes dhe avancimit të Forcës së Sigurisë. Ministri Demolli potencoi edhe faktin që ShBA-ja ka ndihmuar dhe po e ndihmon me të madhe FSK-në si në shkollimin e oficerëve dhe nënoficerëve, po ndihmon edhe në trajnimin dhe profesionalizimin, si dhe vazhdimisht po e mbështet forcën tonë edhe në pajisje dhe donacione të ndryshme. Ministri Haki Demolli, me këtë rast, përmendi edhe bashkëpunimin dhe koordinimin e ngushtë që Ministria dhe FSK-ja kanë me atasheun ushtarak të ShBA-së në Prishtinë, kolonelin Chad Butts, pastaj Zyrën për Bashkëpunim dhe Mbrojtje pranë Ambasadës Amerikane në Kosovë, Ekipin Këshillues të NATO-s për Ministrinë e FSK-së, e gjithashtu një mirënjohje të veçantë e shprehu për kontingjentin amerikan në kuadër të KFOR-it, të cilët siç tha ministri për kaq vjet kontribuojnë në të mirë të paqes dhe sigurisë në Republikën e Kosovës. Më tej, i pari i Ministrisë e informoi gjeneralin Grass edhe mbi zhvillimin e Ministrisë dhe të FSK-së, bashkëpunimin me ShBA-në dhe vendet tjera me të cilat kemi marrëveshje dypalëshe, gjithashtu një kohë të mirë të bisedës ia kushtoi edhe procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Për çështjen e transformimit në Forca të Armatosura, Ministri Demolli tha se kjo temë është prioriteti i Qeverisë së vendit, dhe përgjatë tërë këtij procesi ne do të jemi transparent dhe të hapur me miqtë dhe partnerët tanë strategjik, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ministri tha se FAK nuk do të paraqet kërcenim për regjionin, përkundrazi do t'i kontribuojë stabilitetit në rajon dhe më gjerë. Nga ana e tij shefi i Gardës Kombëtare të ShBA-ve, gjeneral Grass, tha se sa herë që viziton Kosovën e dallon progresin dhe zhvillimin këtu, duke theksuar se kjo është një tregues se populli këtu është shumë energjik. Më tej gjenerali Grass tha se Garda Kombëtare e ShBA-së qëndron fuqishëm në mbështetje të zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në këtë fazë si dhe në fazën e ardhshme të zhvillimit tuaj. Ne do të mbështesim edhe Forcën e ardhshme posa këtë vendim për transformim ta merr Parlamenti juaj. Ne shtoi më tutje Shefi i Gardës Kombëtare të Aiovës, gjenerali Grass, do të kemi shkëmbime edhe më tutje në mënyrë që njohjet dhe miqësia jonë të jetë më e thellë dhe e qëndrueshme. Gjatë përmbylljes së fjalës së tij gjenerali Grass i shprehu mirënjohje ministrit Demolli me fjalët „Faleminderit që po na lejoni të jemi pjesë e ndërtimit të paqes dhe zhvillimit tuaj". Ndërsa, nënkolonel Jeton Dreshaj, shef i Zyrës për Transformim prezantoi para ministrit dhe gjeneralëve aktivitetet e planifikuara dhe përgatitjet që janë duke u bërë rreth procesit të transformimit. Në këtë takim, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Aiovës dhe në përgjithësi me Gardën Kombëtare të ShBA-së është i shkëlqyer dhe se ky bashkëpunim është duke u thelluar edhe më tutje. Nga ana e tij edhe gjeneral major Timothy Orr konfirmoi marrëdhënie të mira dypalëshe në mes FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Aiovës, marrëdhënie këto të cilat janë në kuadër të partneritetit shtetëror Kosovë-Aiovë. Në takimin e përbashkët të Ministrit Demolli me gjeneralin Grass morën pjesë edhe zëvendësministri i FSK-së, Muhamet Latifi, si dhe oficerë tjerë të lartë amerikanë dhe të FSK-së.





Ministri i FSK-së Haki Demollipriti në vizitë ministrin e Mbrojtjes të Hungarisë Istvan Simicsko

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli priti në viztë ministrin e Mbrojtjes të Hungarisë, Istvan Simicsko me bashkëpunëtorë. Me këtë rast Ministri Demolli duke i shprehur mirëseardhjen në Ministrinë e FSK-së, për herë të parë një ministri të Mbrojtjes të Hungarisë, tha se ndjehet tejet i lumtur që Ministria e Mbrojtjes e Hungarisë, ministri hungarez i Mbrojtjes ka marrë hapa të sigurt dhe të shpejtë në drejtim të fillimit të një bashkëpunimi të ngushtë dhe konkret. Gjithashtu, Ministri Demolli e falënderoi ministrin Simicsko për tërë kontributin që Hungaria ka dhënë për Kosovën, fillimisht me angazhimin e KFOR-it në Kosovë dhe akoma vazhdon të mbetet ruajtëse dhe kontribuuese e paqes këtu. Më tej ministri Haki Demolli shprehu falënderimin për gatishmërinë e palës hungareze që bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë të jetë dypalësh, pra të formatizohet dhe të konkretizohet me nënshkrimin nga të dyja palët në një të ardhme të afërt. Ministri Demolli, tha gjithashtu se me arritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes me Hungarinë, ne si Kosovë do ta krijonim një hartë pozitive të bashkëpunimit në Ballkan dhe Evropën Juglindore, sepse shtoi ministri ne përveç se kemi marrëveshje me shumë partnerë tanë strategjikë që janë edhe vende anëtare të NATO-s, kemi marrëveshje dypalëshe edhe me disa prej vendeve të Ballkanit që tani më veç janë anëtare të NATO-s, si dhe me disa të tjera që aspirojnë për anëtarësim në strukturat veriatlantike. Ministri Demolli e njoftoi kolegun e tij, ministrin hungarez të Mbrojtjes edhe me procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, duke ia bërë të ditur se i tërë procesi i transformimit do të jetë transparent dhe se do të behët në koordinim me partnerët tanë strategjikë. I pari i Ministrisë së FSK-së, zotëri Demolli tha se janë kryer të gjitha përgatitjet dhe se tani i mbetet Parlamentit të Kosovë të vendosë për transformimin, por Ai konfirmoj edhe një herë se Forca e Armatosur do të jetë forcë mbrojtëse, forcë kontribuuese për ruajtjen e paqes në vend dhe rajon si dhe do të jetë forcë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim. Ministri Demolli në fund e falënderoi ministrin Simicsko për vizitën si dhe e përgëzoi për përballjen e përditshme me valën e refugjatëve si nga Ballkani ashtu edhe nga Lindja e Mesme dhe Afrika. Nga ana e tij ministri hungarez i Mbrojtjes, Istvan Simicsko tha se Hungaria ka njohur Pavarësinë e Kosovë, njeh përparimet që ka bërë Kosova në të gjitha drejtimet. Ai tha se neve nuk na ka penguar asgjë që Kosovës t'i japim votën pro në UNESCO, gjithashtu tha Ministri Simicsko ne tani më jemi në përpjekje që sa më shpejt të arrijmë marrëveshje zyrtare të bashkëpunimit, duke ditur se Hungaria ka gatishmëri që ta mbështesë FSK-në në trajnim dhe edukim, si dhe në shumë fusha tjera me interes të përbashkët. Ministri i mbrojtjes së Hungarisë, Istvan Simicsko tha se kjo është hera e parë që vizitoj Kosovën, ky vend ofron mundësi të mira për shumë fusha. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe zëvendësministri Muhamet Latifi, gjeneral brigade Zymer Halimi drejtor i Drejtorisë së Operacioneve si dhe Sinan Geci shef i Sektorit për Bashkëpunim Euro-Atlantik.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Intervistë me shefin e Shtabit të Gardës Kombëtare të Shtetit të Ajovës kolonel Michael Amundson

Jam i impresionuar me arritjet dhe zhvillimet profesionale të FSK-së

Gazeta "Forca Jonë": *Zoti Kolonel, në cilësinë e shefit të Shtabit të Gardës Kombëtare të Ajovës ju jeni drejtpërdrejt i kyçur në planifikim dhe koordinim të planit vjetor të trajnimeve në kuadër të partneritetit ndërmjet Gardës së Ajovës dhe FSK-së. Si e vlerëson realizimin e këtyre aktiviteteve dhe çka planifikoni për të ardhmen?*

Kolonel Michael Amundson: Aktivitetet që Garda Kombëtare e Ajovës i kryen në mbështetje të Ministrisë së Forcës së Sigurisë, Komandës së Forcave Tokësore dhe njësive të e saj vartëse janë të koordinuara dhe të sinkronizuara ngushtë nëpërmjet Kolonel Ilir Qeriqit ("COL Q"), Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Oficerit për Çështje Bilaterale të Gardës Kombëtare të Ajovës. Garda Kombëtare e Ajovës është shumë krenare me raportin që e kemi me Forcën e Sigurisë së Kosovës, por edhe udhëheqja jonë shtetërore civile është mjaft krenare me këtë raport. Në fakt, ata janë kaq krenarë saqë udhëheqja jonë e lartë, Guvernatori Teri Branstad dhe Gjeneralmajor Tim Or kanë punuar me drejtorët e departamenteve tjera në Ajovë për të inkurajuar një qasje të partneritetit tonë "e tërë Ajova - e tërë Kosova".

Gazeta "Forca Jonë": *Kolonel, ju vizitoni zyrtarisht FSK-në herë pas here, si e shihni progresin e FSK-së në fushat që Garda e Ajovës ka dhënë kontribut?*

Kolonel Michael Amundson: Vizita ime e pare në Kosovë ka qenë në vjeshtën e vitit 2012, që nga atëherë, kam parë një progres të madh në FSK. Kjo është vizita ime e katërt dhe unë jam i impresionuar në veçanti me avancimin e aftësive të SKI-së, ku ka qenë e përfshirë edhe Ajova. Që nga vizita ime e parë, FSK-ja ka shtuar Zërin Përmes IP (VoiceOver IP), një rrjet i mbyllur për përdorim të brendshëm dhe bashkëpunim së bashku me një rrjet të hapur për operacione ditore dhe për përdorim të përgjithshëm.

Gazeta "Forca Jonë": *Si e shihni zhvillimin e FSK-së në përgjithësi nga perspektiva juaj si oficer i lartë me përvojë dhe si shef i Shtabit, ku e vlerësoni se FSK-ja ka progres më shumë, si dhe në cilat fusha duhet punuar më shumë në të ardhmen?*

Kolonel Michael Amundson: Përveç atyre që i përmenda më lart, unë po ashtu kam parë edhe një sërë përmirësimesh në tërë komandën, duke filluar me përmirësimin e aktiviteteve të personelit e deri te mbikëqyrja e operacioneve të FSK-së brenda katër kompetencave thelbësore të saj. Është e vështirë që të piketohet një pikë specifike që ka nevojë për progres të mëtejmë, por sikur të duhej ta identifikoja një gjë të vetme, ajo mund të ishte në fushën e lëvizjes prej një filozofie qendrore të planifikimit në një ambient më të decentralizuar të planifikimit dhe ekzekutimit. Por megjithatë, më duhet të them se jam shumë krenar me FSK-në dhe i pres me padurim ngjarjet e PPSH-së në të ardhmen.

Gazeta "Forca Jonë": *FSK dhe Garda Kombëtare e Ajovës janë në partneritet dhe kjo është e rregulluar zyrtarisht, por për lexuesit çka mund të na thoni si është ndjenja e bashkëpunimit me oficerët e FSK-së dhe në përgjithësi me zyrtarët dhe udhëheqësit e Ministrisë dhe FSK-së?*

Kolonel Michael Amundson: Partneriteti shtetëror i Gardës Kombëtare të Ajovës me Forcën e Sigurisë së Kosovës është i rregulluar zyrtarisht nëpërmjet programit të Departamentit të Mbrojtjes që quhet "Programi i Partneritetit Shtetëror", i cili i lidh organizatat e Gardës Kombëtare në të 54 shtetet dhe territoret me vendet në zhvillim. Si shumë oficerë të tjerë që kanë pasur mundësinë të vijnë këtu në Kosovë, unë sigurisht jam MË SË SHUMTI krenar për raportet që i kam krijuar me shumë oficerë nga e tërë Forca e Sigurisë së Kosovës. Më besoni se të gjithë ne, qe kemi pasur mundësinë të shërbejmë këtu, jemi shumë krenar për shërbimin tonë dhe për kontributin e vogël që kemi dhënë për të ardhmen e këtij kombi.



Gazeta "Forca Jonë": *A e ndjeni perceptimin pozitiv dhe mirënjohjen që ka FSK-ja për Gardën Kombëtare të Ajovës dhe Ushtrinë e ShBA-ve?*

Kolonel Michael Amundson: Është e padiskutueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kosova e kanë një raport shumë të veçantë dhe mirënjohja e popullit të Kosovës ndaj Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës është mjaft e dukshme pothuajse në secilin vend të Kosovës që e kam vizituar. Është e pazakonshme të shihet flamuri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës të valojë në vendet tjera që i kam vizituar, përveç reparteve ushtarake dhe ambasadave ku i kemi operacionet tona. Ndërsa këtu në Kosovë kam parë shumë flamuj amerikanë, dhe kjo për mua thotë shumë më tepër se çdo gjë tjetër lidhur me respektin që kosovarët kanë për SHBA-të.

Gazeta "Forca Jonë": *A keni diçka të shtoni për fund?*

Kolonel Michael Amundson: Së pari, dëshiroj që ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, por edhe qytetarët e Kosovës, të dinë se ushtarët dhe pjesëtarët e forcave ajrore të Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët kanë shërbyer në Kosovë në kuadër të KFOR-it dhe të cilët e kanë mbështetur organizatën nëpërmjet Ekipit Këshillues të NATO-s dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s, janë shumë krenarë që kanë shërbyer këtu.

Së dyti, mendoj se është e rëndësishme që të gjithë kosovarët ta kenë parasysh historinë e jashtëzakonshme të kësaj toke. Të kenë parasysh sakrificat e jashtëzakonshme që janë bërë për krijimin e Shtetit të Kosovës.

Dhe në fund, duhet të dini që ekziston një e ardhme e ndritshme këtu në Kosovë dhe Ajova është shumë krenare që është pjesë e kësaj të ardhmeje. Me zvogëlimin e pjesëtarëve të NATO-s dhe KFOR-it në vitet që po vijnë, jini të sigurt që raporti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Gardën Kombëtare të Ajovës do të mbeten nëpërmjet Programit të Partneritetit Shtetëror.

U shënua 'Dita e Forcës' me aktivitete të shumta

Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) për nder të "Ditës së Forcës" ka hapur të gjitha kazermat për qytetarët e Kosovës. Manifestimi qendror u mbajt në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, ku morën pjesë nxënës, qytetarë dhe personalitete ushtarake dhe politike dhe përfaqësues diplomatik të akredituar në Republikën e Kosovës. Me rastin e 27 Nëntorit ,,Ditës së Forcës", ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministrat Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Zymer Halimi, Nazmi Brahimaj, Gëzim Hazrolli dhe Bashkim Jashari, si dhe oficerë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së, në orët e paradites bënë vizita në Kompleksin Memorial ,,Adem Jashari" në Prekaz dhe në familjen Jashari. Delegacioni i FSK-së, fillimisht bëri homazhe në shenjë nderimi për sakrificën e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe të familjes Jashari dhe më pastaj vizitoi edhe familjen Jashari, ku u pritën nga kryefamiljari Rifat Jashari. Për të kremtuar "Ditën e Forcës" bashkë me ushtarakët e FSK-së, ishin të pranishëm edhe presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga, ministri i FSK-së, zoti Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministra, ministra, deputet, gjeneralë, zëvendëskomandanti i KFOR-it, oficerë të FSK-së, të KFOR-it, të NLAT-it, NAT-it etj. Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga së bashku me krerët e FSK-së, vendosën lule të freskëta tek "Obelisku i të rënëve", në shenjë nderimi për të gjithë të rënët për liri, dhe pastaj vizituan të gjitha tendat në të cilat u prezantuan aktivitetet e FSK-së, makineritë, aparaturat, mjetet teknike me të cilat punojnë, si dhe përcollën nga afër demonstrimin e Njësisë së Kërkim-Shpëtimit, ku u improvizua shpëtimi I njerëzve nga Kulla etj. Me këtë rast, presidentja e Kosovës znj. Jahjaga tha se shumë shpejtë do të krijohen Forcat e Armatosura të Kosovës dhe se Kosova shumë shpejt do të hyjë në marrëveshje speciale me NATO-n. Ministri Demolli, gjatë fjalës së tij përshëndetëse tha se FSK-ja është e gatshme dhe e përgatitur për t'u transformuar në Forca të Armatosura të Kosovës. Në shenjë respekti për Ditën e Flamurit " 28 Nëntorin" dhe ditëlindjen e Komandantit Legjendar Adem Jashari, erdhëm të vizitojmë Kompleksin Memorial Përkujtimor të familjes Jashari dhe Prekazin në përgjithësi. Gjithsesi, do të shkojmë të vizitojmë familjen Jashari. Ndërsa, në emër të familjes Jashari, foli Rifat Jashari, i cili falënderoi ushtrinë e shtetit të Kosovës si dhe të gjithë shqiptarët që e vizitojnë dhe e nderojnë familjen Jashari. Po ashtu edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjeneral Rama tha se kjo festë FSK-në e gjen shumë të përgatitur profesionalisht si dhe në kuptimin e pajisjeve. Gjithashtu, për nder të Ditës së Forcës, FSK-ja i ka hapur të gjitha kazermat për vizitorë si në Prishtinë, Mitrovicë, Istog, Gjilan, Prizren, Ferizaj dhe Pomozotin, me moton "Dita e Forcës-Ditë e Hapur". Qytetarët e Kosovës gjatë vizitave në kazermat e FSK-së kanë përcjellë nga afër demonstrimet e pjesëtarëve të FSK-së, ku janë ndarë shumë të kënaqur me zhvillimet, demonstrimet dhe arritjet e FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama me rastin e ,,Ditës së Forcës", ka marrë letra urimi nga Kryeshefi i Shefave të Bashkuar të Shtabeve të Ushtrisë së ShBA, gjeneral Joseph F. Dunford JR, Komandanti Gjeneral i Forcave të Armatosura të Turqisë gjenerali me pesë yje, Hulusi AKAR dhe Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majori Timothy Orr.









Komandanti i FSK-së në "Ditën e Forcës" merr urime të shumta

□etër urimi me rastin e □□ □ëntorit, □itës së Forcës□për Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës nga Kr□eshe□i i She□ave të Bash□uar të Shta□eve të □shtrisë së Shteteve të Bash□uara të □meri□ës, gjenerali □oseph F□□un□ord □R□

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant RrahmanRama pranoi një letër urimi nga Kryeshefi i Shefave të Bashkuar të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara(ShBA), dhe gjeneral i Trupave amerikane të Marinës, gjenerali Joseph F. Dunford JR. Ndër të tjera në letër shkruan:

I nderuari gjeneral Rama,
Me rastin e 27 Nëntorit ,,Ditës së Forcës'' në emër të burrave dhe grave të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Shefave të Bashkuar të Shtabeve, ju uroi Ju dhe pjesëtarëve të organizatës suaj Ditën e Forcës së Sigurisë sëKosovës. Forca e Sigurisë së Kosovës, vazhdimisht po dëshmon që është e gatshme të mbështes qytetarët e Kosovës, pa dallime etnike, në situata të emergjencave natyrore dhe fatkeqësive tjera. Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është krenare me të arriturat e Forcës, dhe ne jemi të përkushtuar ta vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë bilateral.



□ulusi □K□R Komandant Gjeneral i Forcave të □rmatosura të □ur□isë

Hulusi AKAR
Komandant Gjeneral
i Forcave të Armatosura të Turqisë

27 Nëntor 2015

RrahmanRama
Gjenerallejtënant
Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës

I nderuar Gjeneral,
Në emër të gjithë pjestarëve të Forcave të Armatosura të Turqisë dhe në emrin tim, kam dëshirë të ju përcjell përshëndetje të përzemërta dhe urime juve dhe pjestarëve të shquar të Forcës së Sigurisë së Kosovës me rastin e festimit të Ditës së Forcës më 27 Nëntor.
Pres një thellim të mëtejshëm të lidhjeve bashkëpunuese miqësore dhe ushtarake në mes të Ushtrive tona për qëllime paqësore, të sigurisë dhe stabilitetit.
Ju uroj juve dhe pjestarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës shëndet dhe sukses të vazhdueshëm.

□etër urimi me rastin e □□ □ëntorit, □itës së Forcës□për Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës nga Komandanti i Gardës Kom□etare të □iovës□ShB□□, gjeneral major □imoth□□□□rr

Gjenerallejtënant Rrahman Rama
Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës

I nderuar Gjeneral Rrahman Rama:
Po ju shkruaj që të ju përgëzoi juve dhe ekipin tuaj për një vit tjetër të suksesshëm, dhe të ju dëshiroj juve dhe pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës punë të mbarë për nder të Ditës së Forcës. Kjo ditë, është themeluar për të shënuar ekzistencën e deritanishme të FSK-së, por gjithashtu është edhe ditë e madhe për të vlerësuar krejt atë çka është arritur këtë vit që kaloi në shërbim të popullit të Kosovës. Edhe njëherë FSK-ja ka dëshmuar pse është njëra nga institucionet më të besuara dhe respektuara në Kosovë. Duke filluar nga përgjigjja juaj në thirrjet për kërkim- shpëtim, pastaj vazhdimin e aktiviteteve të deminimit, punën e kryer në mënyrë të suksesshme gjate ushtrimeve dhe përpjekjet për integrim, FSK-ja vazhdon të jetë një forcë stabilizuese dhe garantuese për qytetarët e juaj të nderuar. Si një partner shtetëror i juaji, ne vazhdojmë të jemi jashtëzakonisht krenarë për marrëdhëniet e forta që janë ndërtuar në mes burrave dhe grave të forcave tona. Së bashku, ne kemi përfunduar më shumë se 30 aktivitete ushtri-ushtri, duke përfshirë afër 70 ushtarë dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore të Gardës Kombëtare të Aiovës që kanë udhëtuar për në Kosovë dhe afër 25 pjesëtarë të FSK-së që kanë marrë pjesë në aktivitetet SPP në Ajova. Kjo e bënë partneritetin tonë shtetëror një ndër programet më aktive e më të suksesshme në tërë Evropën. Kjo është një e arritur që na bënë të gjithëve krenarë.
Synoj dhe presim një vit tjetër të mbarë, që të punojmë së bashku, të forcojmë marrëdhëniet e qëndrueshme në mes të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe marrëdhëniet e veçanta mes Gardës Kombëtare të Aiovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Sinqerisht Timothy E. Orr
Gjeneral Major, Garda Kombëtare e Ajovës
Adjutant General



Gjeneral Rama nderoi ushtarët e rënët britanikë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në ceremoninë e homazheve pranë memorialit britanik, në bazën kryesore të KFOR-it në "Film City" në Prishtinë, në nderim të ushtarëve britanikë të rënë gjatë luftës së Parë Botërore e deri tek ata të cilët ranë edhe në Kosovë. Gjeneral Rama së bashku me Presidenten e vendit, Atifete Jahjaga, ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, Ruairi O' Connell, përfaqësues të KFOR-it etj, vunë kurora lulesh në memorialin britanik në bazën kryesore të KFOR-it. Kjo ceremoni u organizua nga Ambasada e Britanisë në Kosovë për nderë të 100- vjetorit të rënies së dhjetëra miliona njerëzve gjatë kësaj lufte e cila shkatërroi tërë Evropën.

Delegacioni i MFSK-së vizitë në Ministrinë e Mbrojtjes të Gjermanisë

Drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane (DPP) i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), FarukGeci, drejtori i Drejtorisë për Operacione dhe Trajnime (DOT), gjeneral brigade Zymer Halimi, si dhe shefi i Zyrës për Transformim, nënkolonel Jeton Dreshaj qëndruan për një vizitë zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë. Delegacioni i zyrtarëve dhe oficerëve të lartë të FSK-së u pritë nga kundëradmirali Jugel, udhëheqës i Zyrës së Planifikimit të Ushtrisë së Gjermanisë. Ndër të tjera gjatë takimit u fol për bashkëpunimin ndërmjet dy ministrive, si dhe për procesin e planifikimit në Ushtrinë gjermane. Zotëri Geci, gjeneral Halimi, nënkolonel Dreshaj të shoqëruar edhe nga drejtori i Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT) për FSK-në, gjeneral brigade Stefan Linus Fix vizituan Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë, përkatësisht Zyrën për Politika dhe Plane, ku u njohën nga afër me punën e kësaj zyre. Gjatë takimit u diskutuan mundësitë e vazhdimit të bashkëpunimit dypalësh, po ashtu me theks të veçantë u nënvizuan zhvillimet rreth procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Nga pala gjermane u shpreh gatishmëria për mbështetje të mëtejme dhe thellim të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona. Delegacioni nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës mori pjesë edhe në ceremoninë e shënimit të 60- vjetorit të Forcave të Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë, i cili u mbajt në Parlamentin gjerman e ku ishin të pranishëm edhe Presidenti, Kryeministrja dhe Ministri i Mbrojtjes së Gjermanisë.



Ushtarakë nga Shqipëria vizituan MFSK-në dhe FSK-në



Një delegacion ushtarak i oficerëve të Kursit të Lartë të Sigurisë së Mbrojtjes të Akademisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, qëndroi për një vizitë zyrtare dy ditore në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Delegacioni i ushtarakëve nga Shqipëria i përbërë nga përfaqësues të institucioneve tjera të sigurisë dhe oficerë të vendeve të rajonit dhe më gjerë, vijues të tjerë të cilët po ndjekin Kursin e Lartë të Sigurisë në Akademinë e Shqipërisë, gjatë vizitës në Ministrinë e FSK-së u pritën nga zëvendësministri i MFSK-së, zoti Fadil Gashi dhe drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë për FSK-në, gjeneral brigade Zymer Halimi dhe nënkolonel Hasan Hoxha, zëvendësdrejtor i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim në MFSK. Zëvendësministri Gashi pasi përshëndeti delegacionin nga Shqipëria për vizitën e tyre në Kosovë, ai njëherësh i njoftoi edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, bashkëpunimin e përgjithshëm të FSK-së me partnerët ndërkombëtarë dhe me Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, si dhe me transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK). Kurse, drejtori i Drejtorisë për Operacione në MFSK gjeneral Halimi, delegacionin nga Shqipëria e njoftoi me misionin e FSK-së, strukturën, kapacitetet, bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar dhe bashkëpunimin me NATO-n, (përmes dy ekipeve këshilluese në MFSK dhe FSK) si dhe me bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ndërsa, për rolin e Ekipeve Këshilluese të NATO-s, në Ministri dhe FSK, delegacionin nga Shqipëria e njoftoi drejtori i NAT, zotëri Dominic Braithwaite. Në emër të delegacionit nga Shqipëria, zëvendësministrin Gashi dhe gjeneral Halimin i falënderoi kolonel Izet Haxhia. Delegacioni ushtarak nga Shqipëria vazhdoi vizitat në Komandën e Forcave Tokësore dhe Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, ku u pritën nga zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli i cili i njoftoi me të arriturat e përgjithshme të Komandës së Forcave Tokësore dhe njësive tjera të FSK-së. Delegacioni ushtarak nga Shqipëria vazhdon vizitën edhe për dy ditë në njësitet tjera të FSK-së.

FSK-ja së bashku me Ambasadën e SHBA-ve shpërndanë ndihma humanitare për banorët e fshatrave të vitisë dhe Kaçanikut



Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Zyrën Mbështetëse Civilo-Ushtarake të Ambasadës Amerikane në Prishtinë, ku së bashku kanë realizuar tri projekte humanitare; dhurim të donacioneve me materiale të agrikulturës dhe me veshmbathje. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Departamenti i BCU-së i MFSK-së, më datë 12, 13 dhe 18 nëntor 2015, këtë donacion ia ka dhuruar Shoqatës së grave në fshatin Lubishtë dhe asaj në Remnik, Komuna e Vitisë, në vlerë prej 3000 eurove, Shoqatës së grave në fshatin Begrac Komuna e Kaçanikut, pajisje dhe materiale në vlerë prej 1000 eurove, si dhe veshmbathje për Kryqin e Kuq të Kosovës në Kaçanik. Në shpërndarjen e ndihmave materiale morën pjesë drejtori i Departamentit të BCU-së, z. Hajrush Kurtaj dhe shefi i Zyrës për Çështje Civile në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, z. Peter Presinger.

Trajnime nga instruktorë amerikanë

U mbajt trajnimi Planifikimi taktik në nivel të kompanisë

Pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ndoqën për tre ditë seminarin me temë: "Planifikimi taktik në nivel të kompanisë", i cili u realizua nga instruktorët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), përkatësisht nga marinsat amerikanë. Në përmbyllje të seminarit ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Forcave Tokësore (KFT), kolonel NaimHaziri, i cili falënderoi ushtarakët amerikanë për bashkëpunimin dhe mbështetjen që Ushtria Amerikane po i bën Forcës së Sigurisë së Kosovës. Nga ana e tjetër, kolonel Haziri kërkoi nga pjesëtarët e FSK-së që njohuritë e fituara nga instruktorët amerikanë t'i transmetojnë nëpër njësit e tyre. Gjatë seminarit janë zhvilluar temat si: Planifikimi, përpilimi i urdhrave sipas standardeve të marinsave, si dhe tema tjera të kësaj fushe. Seminarin e ndoqën 20 pjesëtarë nga të gjitha njësitë e FSK-së. Në fund si shenjë falënderimi kolonel Haziri ndau mirënjohje për instruktorët nga ShBA-të.





Ambasadorja e Finlandës Anne Huhtamaki vizitë në Ministrinë e FSK-së

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, zotëri Haki Demolli priti në ambientet e Ministrisë ambasadoren e Finlandës në Prishtinë, znj. Anne Huhtamaki. Ministri Demolli pasi i uroi mirëseardhje ambasadores finlandeze, ai njëherazi e falënderoi për bashkëpunimin dhe ndihmën që shteti i saj po jep për Kosovën edhe FSK-në. Një vlerësim të veçantë ministri shfaqi edhe për votën e Finlandës pro anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, ditë më parë në Paris, si dhe për angazhimin e kontingjenteve ushtarakë në kuadër të misionit të KFOR-it në Kosovë dhe në kuadër të Ekipit këshillues të NATO-s për MFSK-në. Ministri Demolli gjatë takimit e njoftoi ambasadoren e Finlandës edhe me zhvillimet në MFSK, duke nënvizuar procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK). Po ashtu ministri Demolli foli edhe për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve dhe ministrive të Mbrojtjes, me theks të veçantë për mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit si dhe arritjen e një marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e mbrojtjes dhe sigurisë së Finlandës. Nga ana e saj, ambasadorja e Finlandës në Prishtinë, znj. Anne Huhtamake pasi falënderoi ministrin Demolli për pritjen, shprehi kënaqësinë për bashkëpunimin e deritashëm në mes dy shteteve duke vlerësuar arritjet e FSK-së në të gjitha fushat. Zonja Huhtamake në fund u shpreh për thellimin dhe vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

Certifikohen 30 pjesëtarë të FSK-së në trajnimin" Zhvillimi i specifikimeve teknike dhe hulumtimi i tregut

Në kazermën "Adem Jashari"në Prishtinë u mbajt ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët për pesë ditë më radhë ndoqën trajnimin " Zhvillimi i specifikimeve teknike dhe hulumtimi i tregut II" nga ekipi mobil i instruktorëve të "SATMO-s" nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA). Për të përcjellë këtë ceremoni të pranishëm ishin edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli me bashkëpunëtorë. Ai, me këtë rast, i përgëzojë instruktorët dhe pjesëtarët e FSK-së, për angazhimin dhe suksesin e



treguar gjatë trajnimit. " Është kënaqësi që kemi mundësi të organizojmë trajnime të tilla nga ekspertë të fushave të ndryshme e që janë mjaft të rëndësishme për të ardhmen e FSK-së, siç është kjo e prokurimit". Gjeneral Hazrolli, ka falënderuar ekipin e instruktorëve amerikanë, për bashkëpunimin dhe ndihmën profesionale gjatë trajnimeve të ndryshme , "të gjitha këto trajnime të cilat po realizohen si rezultat i bashkëpunimeve të ndryshme kanë ndihmuar pjesëtarët e FSK-së, që të ecin përpara në zhvillimin e njohurive të tyre. E falënderoj ekipin e instruktorëve për këtë trajnim si dhe pjesëtarët e FSK-së për angazhimin e treguar. E vlerësoj gjithë atë që kemi arritur falë këtyre trajnimeve, dhe jam i sigurt se njohuritë e fituara këtu do të na ndihmojnë shumë në të ardhmen ", shtoi në fund zëvendës komandanti i KFT-së, gjeneral Hazrolli. Qëllimi i këtij trajnimi të realizuar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me SHBA-në ishte që të investohet sa më shumë në aftësimin dhe ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Trajnimi ka filluar më 16 nëntor dhe ka përfunduar më 20 nëntor 2015, ku u shtjelluan tema të ndryshme, si: Etika e tregut, hulumtimi i tregut, specifikat teknike si dhe cilësia e tregut. Ndërsa, koloneli Dejvis nga ekipi i SATMO-s dhe nënkolonel Zejnullahu nga FSK-ja, u shprehën të kënaqur me realizimin e këtij trajnimi, duke vlerësuan lart bashkëpunimin dhe mbarëvajtjen e tij.

41 pjesëtarë të komuniteteve të FSK-së kryejnë kursin e gjuhës shqipe

Më 30 tetor 2015, në kazermën e Batalionit të Parë të Reagimit të Shpejtë të FSK-së, në Gjilan, u organizua ceremonia e certifikimit të 41 pjesëtarëve të komuniteteve, pas kryerjes së kursit 8 javor të gjuhës shqipe. Ky është viti i dytë, që po organizohet dhe po mbahet kursi i mësimit të gjuhës shqipe, për pjesëtarë të komuniteteve të cilët janë pjesëtarë të FSK-së. Kursi ka filluar më 31 gusht 2015, ka zgjatur 8 javë, është mbajtur në dy nivele dhe të gjithë pjesëmarrësit e kursit janë të komunitetit serbë. Mbajtja e kursit të gjuhës shqipe është organizuar me qëllim të lehtësimit të komunikimit të pjesëtarëve të komuniteteve, brendapërbrenda njësive, në kryerjen e detyrave si dhe mundësinë e ngritjes profesionale të tyre. Pas kryerjes së kursit, më 23 tetor, u mbajt edhe testimi i njohurive të dijes. Pjesëmarrësit treguan suksese të mira në mësimin e gjuhës shqipe. Në certifikimin e kursantëve, morën pjesë; komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama, atasheu amerikan, kolonel Antoni Butts, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefja e Zyrës për Komunitete në MFSK AzeminaCullum, komandanti i BRSH-së kolonel Xhevahir Geci dhe major IbtrahimRevuqi, zëvendëskomandant i Batalionit të Parë të BRSH-së në Gjilan.



Gara sportive për nder të ,,Ditës së Forcës"

Futbollistët e BRSH-së më të mirët

Në kazermën e FSK-së "Evropianet e Rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Pomozotin (RMC), u mbajt finalja e futbollit ndërmjet ekipit të futbollit të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe Regjimentit të Mbrojtjes Civile, ku vendin e pare e zuri ekipi i Batalionit të Dytë në Istog me rezultat 2-1. Pas përfundimit të këtij takimi u mbajt edhe ceremonia e shpërndarjes së mirënjohjeve dhe shpërblimeve për pjesëtarët dhe ekipet e Forcës së Sigurisë së Kosovës që morën pjesë në aktivitetin sportiv për nder të " Ditës së Forcës" 27 Nëntorit. Për të përcjellë nga afër këtë ceremoni të pranishëm ishin edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant RrahmanRama, zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, ushtrues detyre i komandantit të Brigadës së Mbështetjes Operacionale, kolonel Muharrem Rrahmani, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, komandanti i Batalionit të Dytë i Brigadës për reagim të Shpejtë (BRSh), nënkolonel Mehmet Lladrovci si dhe nënkolonel Bekim Zejnullahu nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjeve në Ferizaj. Këto gara të cilat kanë filluar me 5 nëntor ishin të fokusuara në katër disiplina: Futboll, Shah, Kros dhe Shenjëtari, ku në të gjitha disiplinat për tri vendet e para u dhanë mirënjohje dhe medalje. Forca e Sigurisë së Kosovës, tani më për çdo vit organizon këtë aktivitet sportiv për nder të "Ditës së Forcës" 27 Nëntorit, në kuadër të gjitha njësive të FSK-së.



Me ushtarët-sportistë të dalluar të FSK-së, në sportet ekstreme

Ushtari Fitim Krasniqi sportisti i parë në sportin e ri 'Parkour-it' në Kosovë



Ushtari i FSK-së, Fitim Krasniqi është nga Prishtina dhe shërben në Batalionin e Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Mitrovicë. Ai, që nga mosha e re, merret me një sport të ri, interesant, shumë atraktiv dhe mjaft ekstrem, jo shumë i njohur për të rinjtë e Kosovës. Ushtar Fitimi thotë: "Me këtë sport kam filluar të merrem që nga mosha 14 vjeçare (2008). Quhet "Parkour "dhe ndryshe njihet edhe si sport urban. "Parkour" është sport atraktiv dhe ekstrem. Për herë të parë është zhvilluar në Francë nga Ushtria Franceze për trajnimin e trupave të saj. Në atë kohë nuk kishte ndonjë emër të caktuar, ndërsa në vitet e 80-ta, David Belle e emërton këtë sport me emrin "Parkour", mirëpo nën këtë emër la edhe një emër tjetër "FreeRunning" (vrap i lirë). Ky emër ndan "Parkour-in" nga akrobacionet, por që të dyja mund të bëhen dhe kombinohen në të njëjtën kohë.
Fitimi flet rreth eksperiencave të para dhe vështirësive që ka hasur në fillimet e tij për zhvillimin e këtij sporti. "Unë me një grup shokësh të cilët ishim inspiruar nga filma të ndryshme për këtë lloj sporti filluam të angazhohemi në këtë drejtim, edhe pse në fillim kemi pas mjaft vështirësi pasi që ishte sport i ri dhe nuk kishim as palestër dhe as trajner të këtij sporti i cili do të na ndihmonte. Ne angazhoheshim vetëm si individ, të motivuar që të arrinim suksese në këtë sport. Pas tri vitesh përvojë kemi kaluar nivelin fillestar dhe tanimë kemi arrit të mësojmë lëvizje të rrezikshme, të cilat filluam t'i xhirojmë dhe t'i postojmë në rrjetet e ndryshme sociale. Këto xhirime menjëherë zgjuan kureshtjen dhe interesimin e madh të publikut, e sidomos interesimin e kompanive të ndryshme filmike dhe medieve të shkruara dhe elektronike, të cilat tani më na konsiderojnë profesionist". Fitimi në vitin 2013, pas një përvoje pesëvjeçare, hapi një shkollë "Parkouri" në shoqëri me të rinjtë e Prishtinës dhe të mbarë Kosovës. Edhe përkundër kushteve jo adekuate në këtë shkollë, mund të themi se janë vënë bazat e këtij sporti në Kosovë. Sot një numër mjaft i madh i të rinjve të Kosovës janë duke u marrë me këtë sport, falë angazhimit dhe rezultateve të punës së Fitimi me shokë. "Ushtrimet, trajnimet dhe aktivitet tjera fizike në FSK, po më ndihmojnë shumë në përgatitjen time fizike, e sidomos po më shtojnë vetëbesimin për të realizuar numra të rrezikshëm të këtij sportit, me anë të secilit po prezantojmë "Parkourin" e Kosovës edhe më gjerë". U ndamë nga Fitimi duke i uruar suksese edhe jashtë Kosovës, pse jo edhe në gara ndërkombëtare të na sjellë medalje dhe tituj suksesi në sportin e "Parkour-it".



Batalioni i Tretë i Brigadës për Reagim të Shpejtë testoi aftësitë fizike në" Marshin e Nëntorit "

Batalioni i Tretë i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) ka realizuar me sukses marshin kondicional "Marshimi i Nëntorit". Marshimi është realizuar në bazë të planit vjetor të aktiviteteve dhe trajnimeve të Batalionit të Tretë, për vitin 2015 dhe është realizuar në zonën e përgjegjësisë së Batalionit të Tretë, në rajonin e Mitrovicës, më saktë në komunat: Vushtrri dhe Mitrovicë. Pjesëtarët kanë përfunduar me kohë marshimin me ngarkesë në gjatësi prej 30 kilometrash, duke dëshmuar kështu se pjesëtarët e Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë posedojnë një përgatitje të lartë fizike dhe janë të gatshëm në përballimin e çfarëdo detyre dhe sfide. Në marshim ka marrë pjesë stafi komandues i Batalionit të Tretë i udhëhequr nga major Beton Retkoceri, komandant i Batalionit si dhe oficerë tjerë të Batalionit dhe këshilltarë të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT) për FSK-në. Qëllimi i këtij marshimi ishte testimi dhe mbajtja e kondicionit fizik të pjesëtarëve të këtij batalioni në distanca të gjata.



FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 42 • Janar 2016 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i FSK-së Haki Demolli priti në vizitë ministren e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë Mimi Kodheli

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli, më 1 dhjetor 2015, priti në vizitë zyrtare, në ambientet e ministrisë, ministren e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli me bashkëpunëtorë. Ministrja e Mbrojtjes të Republikës sëShqipërisë znj. Kodheli u prit me nderime të larta nga Togu i Nderit dhe Orkestra Frymore e FSK-së. Takimi i parë i ministri Demolli dhe ministres Kodheli u zhvillua kokë më kokë, për të vazhduar më pastaj takimin e përbashkët në nivelin e zgjeruar të dy delegacioneve. Ministri Demolli pasi i dëshiroi mirëseardhje ministres Kodheli e njoftoi edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të veçantë ai foli përshkollimin, trajnimet, ngritjen dhe profesionalizimin, si dhe për intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive në të ardhmen. Bashkëpunim ky i cili duhet të vazhdohet dhe begatohet edhe më tutje. Gjatë takimit, ministri Demolli nënvizoi se janë realizuar një numër i madh aktivitetesh të parapara për këtë vit, sipas Planit të Veprimit i cili është rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe ngriti çështjen e vazhdimit të punës së grupeve punuese për konkretizimin e aktiviteteve të Planit të ardhshëm të Veprimit. Gjatë takimit me ministren Kodheli, u diskutuan edhe aspektet e sigurisë në Shqipëri, Kosovë, regjion dhe më gjerë, pas akteve dhe kërcënimeve të fundit terroriste. Po ashtu u bisedua për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, si dhe për situatën politike në Kosovë dhe Shqipëri. Në takimin e përbashkët në mes të dy ministrave dhe dyja delegacioneve u bisedua edhe për përkrahjen që Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria për FSK ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë që mund t'i bëhet Kosovës për anëtarësim në iniciativa regjionale, por edhe për përkrahjen e kërkesës që Qeveria e Kosovë i ka paraqitur NATO-s për dialog politik ndërmjet NATO-s dhe Republikës së Kosovës. Ministri Demolli i ka kërkuar ministres Kodheli që në vitin 2016, Kontingjenti i FSK-së të jetë pjesë e Kontingjentit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me rastin e pjesëmarrjes në ushtrimin ushtarak „Anakonda" që do të mbahet në Poloni. Gjithashtu, ministri Demolli e falënderoi ministren e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, zonjën Kodheli për mbështetjenedelegacionit të MFSK-së që të jetë i barabartë dhe të trajtohet me dinjitet në të gjitha takimet, konferencat si dhe aktivitetet tjera jashtë vendit. Ndërsa, ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Kodheli falënderoi ministrin Haki Demolli për pritjen dhe shtoi se ndjehet mirë këtu edhe përkundër që kjo vizitë po realizohet në një kohë sfidash të përgjithshme. Ajo e



informoi ministrin Demolli për zhvillimet e fundit në Ministri të Mbrojtjes dhe në Forca të Armatosura, si dhe biseduam për zhvillimet politike si në Tiranë ashtu edhe në Prishtinë, me të njëjtin mendim se të gjitha palët duhet të orientohen drejt dialogut politik dhe zgjidhjeve politike. E vetmja rrugë, deklaroi Ministrja Kodheli, për të gjetur zgjidhje është tavolina e bisedimeve dhe angazhimi në Kuvend. Gjuha e rrugës, siç tha ministrja e Mbrojtjes nuk do të mund të zgjidhë asnjëherë çështjet e hapura përkundrazi, dhuna favorizon gjithë qëndrimet kundër të ardhmes demokratike dhe perëndimore. Terrorizmi tha zonja Kodheli është bërë një kërcënim global pas ngjarjeve tragjike të Parisit, Ankarasë, situata tejet e renduar në Belgjikë, alarmet nëBritani dhe Itali kanë cenuar shumë ndjenjën e sigurisë të qytetarëve të këtyre vendeve.

Kosova ka sfidë integrimin në Bashkimin Evropian dhe në strukturat euroatlantike por unë jam gjithashtu e bindur se Ministria për FSK është duke bërë atë më të mirën dhe më të duhurën për qytetarët e Kosovës. Kosova ka sfida të mëdha përpara dhe sfidat e Kosovës janë në sytë e të gjithë neve, dhe ne jemi duke punuar bashkërisht. Në fund, ministrja Kodheli shtoi se me ministrin Demolli ndamë mendimin e njëjtë, për nivelin e bashkëpunimit që kemi midis FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ne të dy palët do të gjemë rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit akoma më të lartë. Ne jemi këtu për ta mbështetur këtë proces në mënyrë që me ndihmën e aleatëve tanë strategjikë dhe të SHBA-s, Shqipëria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën dhe FSK-në, drejt integrimit në NATO dhe Bashkim Evropian, shtoi në fund Ministrja Kodheli. Ministrja Kodhelli vizitoi edhe Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, ku u pritë nga gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zv. komandant i Forcave Tokësore dhe majori Avni Kiqina, komandanti i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së.

FSK-ja më e besueshmja për qytetarët e Kosovës



Në tri anketa të zhvilluara me qytetarët e Kosovës, nga Barometri i Kosovës për Siguri, Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest dhe Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) rezulton se FSK-ja dhe Ministria e FSK-së, janë më të besueshmet për qytetarët e Kosovësme mbi 67%. Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest ka bërë hulumtimin e besimit të qytetarëve në institucionet tona, me 1000 respodent, ku janë përfshirë; Qeveria, Presidenca, Kuvendi, Parlamenti, Policia, Gjyqësori, KFOR-i, EULEX-i, Bashkimi Evropian, ambasadat, sistemi arsimor, shërbyesit civil, partitë politike, mediet, etj. Sipas këtij hulumtimi Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës për qytetarët e Kosovës është institucioni më i besueshëm në Kosovë, për vitin 2015, më 67. 8%. Sipas një sondazhit të Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) me qytetaret e Kosovës shprehen se besimin më të lartë e gëzon FSK-ja dhe Ministria për FSK-në, me vlerësimin mesatar prej 3. 58. Ndërsa, sipas rezultateve të Barometrit të Kosovës për Siguri të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë në Prishtinë, 88% e qytetarëve të vendit të anketuar kërkojnë që FSK-ja të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës.

Intervistë më ministrin e MFSK-së, Haki Demolli

FSK e gatshme për mison të ri



Gazeta "Forca Jonë": *Sipas disa sondazheve që janë bërë ditë më parë, MFSK-ja është vlerësuar institucioni më i besueshëm për qytetarët e Kosovës. Cili është vlerësimi Juaj?*

Ministri Haki Demolli: Fillimisht kisha dashur t'i falënderoj qytetarët të cilët kanë treguar një besueshmëri të madhe ndaj institucionit i cili tash e një vit udhëhiqet nga ana ime. Si udhëheqës i Ministrisë së bashku me bashkëpunëtorët e mi, sot në takimin e rregullt ditor kemi debatuar rreth kësaj, dhe jemi të kënaqur që në tri sondazhe që janë publikuar këtyre ditëve, nga Qendra Kosovare për Studimet e Sigurisë, Riinvesti dhe nga Kipred, ku FSK-ja ka dalë njëri prej institucioneve më të besueshme sa i përket institucioneve të sigurisë me 67. 8% dhe Ministria e FSK-së po ashtu ka dalë të jetë Ministria më e besueshme. Këtë besim të qytetarëve e konsideroj si një shpërblim për punën të cilën e kemi bërë ne si Ministri dhe si Forcë të Sigurisë së Kosovës në përgjithësi.

Gazeta "Forca Jonë": *Zoti ministër, Ju keni dërguar në Parlamentin e Kosovës për votim amendamentet për ndryshimin të Kushtetutës, por një gjë e tillë ende nuk është bërë, si i vlerësoni këto vonesa?*

Ministri Haki Demolli: Po, shihe faktikisht proceset e ndryshme shkojnë etapë-etapë, fazë-fazë lidhur me të cilat vendosin instancat e ndryshme. Ajo çka është më e rëndësishme që kisha dashtë ta informojë lexuesin e medies suaj, është se ne si Ministri e FSK-së atë pjesën e punës sonë e kemi kryer me kohë dhe në mënyrën ma profesionale të mundshme, që do të thotë, amendamentet kushtetuese të cilat kanë qenë të dërguara në Gjykatën Kushtetuese, nga e cila ka marrë ngjyrën e gjelbër qysh vitin e kaluar, ne këtë vit e kemi dorëzuar në Qeveri, kurse Qeveria e ka procedua më tutje në Kuvendin e Kosovës, kuptohet kryesia e Kuvendit të Kosovës duhet ta bëjë vlerësimin se kur ato amendamente mund të dalin në rend të ditës, në mënyrë që të diskutohet dhe të aprovohet nga deputetet e Kuvendit. Po ashtu duhet theksuar se ne si Ministri edhe Ligjin për Transformimin e FSK në Forcat e Armatosura të Kosovës e kemi procedua qysh në muajin maj mirëpo fati i Ligjit varet nga aprovimi i amendamenteve. Për aprovimin e amendamenteve kushtetuese që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së në FAK nevojiten dy të tretat e deputeteve të Kosovës, po brenda këtyre dy të tretave nevojiten edhe votat e dy të tretave të deputeteve nga radhët e pakicave, dhe nuk kam fije dyshimi se të gjithë deputetët e përkatësisë nacionale shqiptare në Kuvendin e Kosovës do të votojnë pa kurrfarë hezitimi për një proces të tillë, po në anën tjetër publikisht janë deklaruar edhe deputetët që vijnë nga minoritetet jo serbe e vetmja pengesë ka qenë deputetët e minoritet serb, të cilët fillimisht nuk kanë dashtë një farë forme të deklarohen publikisht për votën e tyre, por ma vonë ne kemi pas disa biseda me ministrat në Qeverinë e Kosovës që vijnë nga radhët e Listës Sërpska dhe mund të themi se diku nga muaji shtator ka pasur përafrim të qëndrimeve, por për fat tonë, jo të mirë në zhvillim, ecuritë në Kuvendin e Kosovës ishin të tilla sa që prej muajit shtator e deri tash në muajin dhjetor që jemi nuk kemi pas ndonjë seancë të rregullt me përjashtim që disa janë mbajtur në sallën alternative, disa janë mbajtur pjesërisht, por edhe Kryesia e Kuvendit nuk ka vendos që amendamentet për transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës t'i hedhë në rend të ditës.

Gazeta "Forca Jonë": *Kjo do të thotë se situata e krijuar në Kuvend tash e disa muaj, po e vonon FSK-së që të jetë ushtri ?*

Ministri Haki Demolli: Po, në fillim të përgjigjes së dytë thash se proceset janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, prandaj pikërisht zhvillimet brenda Kuvendit të Kosovës kam përshtypjen që kanë ndikuar në shtyrjen e dhënies në rend të ditës të amendamenteve që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura dhe njëherë kanë në një farë forme ndikim në shtyrjen e vetë fillimit të procesit të transformimit.

Gazeta "Forca Jonë": *Si qëndron bashkëpunimi i MFSK-së me vendet e rajonit , Evropës dhe më gjerë?*

Ministri Haki Demolli: Po, mund të them se në planin ndërkombëtar kemi pasur një vit mjaft të suksesshëm nga ato nivele të ndryshme, duke filluar nga bashkëpunimi bilateral e deri te iniciativat regjionale dhe më gjerë. Është e vërtetë, se Ministria e FSK-së deri më tani ka të nënshkruar 11 Memorandume bashkëpunimi me 11 shtete, kryesisht të regjionit, por edhe më gjerë, një numër i të cilave janë anëtare të NATO-s, e dy prej tyre janë kandidate për anëtarësim, njëri prej tyre është Mali i Zi i cili besojmë se shumë shpejt do të anëtarësohet, me ç 'rast i dëshirojmë sukses në rrugën e saj drejt anëtarësimit në NATO. Mirëpo, po ashtu, ne kemi marrëveshje bashkëpunimi edhe me Gardën Nacionale të Ajovës që është njëri prej partnerëve tanë kryesorë dhe mund të themi se nga bashkëpunimi bilateral që kemi pasur me këto shtete kemi pas përfitime të jashtëzakonshme në aspektin e ngritjes profesionale të kudrave tona, sepse përveç të një numri të madh të këtyre shteteve që i përmenda kemi kadetët tanë të cilët janë duke u shkolluar atje, si p. sh. në Maqedoni, Kroaci, Turqi, SHBA, Britaninë e Madhe, Gjermani; njëherësh kemi edhe trajnime të përbashkëta sidomos kemi ekipe mobile të ekspertëve ushtarakë të cilët qoftë që trajnojnë kuadrot tona këtu në Kosovës, qoftë i dërgojmë ne ekspertët tanë, që të marrin njohuri profesionale në këto vende që dita-ditës, mund të themi se po e ngritim forcën tonë në aspektin profesional. Një prej rezultateve të cilat kanë qenë të mirëpritura jo vetëm nga Ministra e FSK-së dhe FSK-ja , ka qenë pikërisht edhe shpallja e kadetët tonë në Britaninë e Madhe në Akademinë Ushtarake Sandurs, si kadeti më i mirë në konkurrencën e oficerëve të 34 shteteve.

Gazeta "Forca Jonë": *Po me NATO-n si qëndron bashkëpunimi?*

Ministri Haki Demolli: Mund të them se ne kemi aktivitete të ndryshme të karakterit bashkëpunues me NATO-n. Në radhë të parë dua ta falënderoj NATO-n, që brenda për brenda Ministrisë dhe FSK-së i ka dy ekipe këshilluese; ekipin e NAT-it dhe ekipin e NLAT-it, me të cilin sikurse unë, po ashtu edhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama, kemi takime të përditshme, dhe të gjitha këto takime kanë qëllimin e ngritjes dhe përsosjes së ministrisë së FSK-së dhe të FSK-së si forcë e uniformuar. Gjatë këtij viti unë si ministër i FSK-së, kam pasur takime edhe me Sekretarin gjeneral të NATO-s, zotin Stotelberg, ku kemi marrë përkrahjen e tij për zhvillimet e brendshme dhe transformimin në përgjithësi me një kujdes që procesi të jetë transparent, çka edhe vërtet kemi bërë, sepse çdo gjë gjatë procesit të transformimit ka qenë mjaft transparente. Po ashtu duhet theksuar se gjate vizitave te ndryshme së bashku me disa eprorë të lartë të Ministrisë së FSK-së kemi vizituar shume vende të NATO-s, ku kemi pasur takime me ambasadorë të shteteve të ndryshme mike, të cilët na kane përkrahur deri me tani dhe kane treguar gatishmëri e tyre, që të na përkrahin edhe në të ardhmen në rrugën tonë drejt integrimeve euroatlantike. Vlen të theksohet se oficerët e FSK-së, kanë marrë pjesë në dhjetëra trajnime të ndryshme, të organizuar nga ana e NATO-s në mënyrë që të përgatitemi gradualisht për një anëtarësim të plotë në një të ardhme jo fortë të largët. Po ashtu, edhe në vitin 2016, ne jemi të ftuar të marrim pjesë në një trajnim-stërvitje të përbashkët që do të mbahet në Poloni, ku numri ma i madh i shteteve të cilat marrin pjesë janë anëtare të NATO-s. Ne do të marrim pjesë me pjesëtarët e FSK-së edhe në aktivitete të karakterit bilateral nëpër vende anëtare të NATO-s, të cilat do të zhvillohen qoftë në Shqipëri, Slloveni apo në vende kandidate të NATO-s, siç është Maqedonia.

Gazeta "Forca Jonë": *Zoti ministër cila është porosia juaj për vitin 2016, për qytetarët e Kosovës?*

Minsitri Haki Demolli: Unë do të kisha dhanë porosinë nga aspekti i sigurisë, për shkak se edhe Ministria e FSK-së e dëshirojmë që gjithë qytetarët tanë të japin kontributin e tyre në sigurinë e Kosovës njëherë të falënderojmë KFOR-in, për angazhimin e tyre dhe të gjithë anëtarët e KFOR-it të cilët po japin kontributin e tyre në afrimin e sigurisë dhe mirëqenies tonë në Kosovë e po ashtu dëshiroj që gjithë pjesëtarëve të FSK-së t'ju uroj një vit të mirë e të mbarë e të suksesshëm me dëshirën më të madhe që ma në fund të fillojë procesi i transformimit të FSK në Forcat e Armatosura të Kosovës, duke krijuar kështu një forcë e cila do të jetë garant i sigurisë dhe stabilitetit regjional jo vetëm të sigurisë në vend por edhe stabilitetit regjional.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Intervistë me Komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama

Edhe këtë vit FSK-ja realizoi të gjitha objektivat

Gazeta "Forca Jonë": *Zoti gjeneral me çfarë suksesi po e përmbyllni një vit kalendarit të punës suaj si komandant i FSK?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama:": Mund të them se FSK-ja është duke e përmbyll edhe një vit shumë të suksesshëm, duke marrë për bazë se të gjitha aktivitet e planifikuara sipas direktivave të Ministrit, por edhe të Komandantit, gjatë kësaj periudhe, janë përmbushur, si arritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale, po ashtu edhe standardet e arritura që nga Komanda, Kontrolli dhe integrimi i minoriteteve, duke përfshirë edhe minoritetin serb, si dhe rritjen e përqindjes të përfshirjes së femrave në FSK. Ne kemi kryer me sukses edhe shumë aktivitete, si: deminimi humanitar, shkatërrimi i mjeteve të rrezikshme, projekte të mëdha në shërbim të komunitetit dhe qytetarëve. FSK-ja ka kryer detyrën dhe obligimin e vet kushtetues dhe ligjor duke iu dal në ndihmë të gjithë qytetarëve pa dallim nacionaliteti dhe feje, gjë të cilën do të vazhdojmë ta bëjmë edhe në të ardhmen në përmbushjen e misionit tonë, duke dëshmuar se. FSK-ja është institucioni më i besueshëm dhe më i respektueshëm në vend.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janë sfidat me të cilat është ballafaquar FSK-ja gjatë këtij viti?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Nuk kisha me thanë se kemi pas ndonjë sfidë të veçantë, që ka qenë e patejkalueshme, përveç asaj të ndërrimin të misionit të FSK-s. Si në aspektin profesional ashtu edhe në atë praktik kemi arrit t'i realizojmë me sukses të gjitha detyrat tona. Gjithashtu kemi arrit t'i plotësojmë disa nga standardet më të larta në fushën e trajnimit dhe shkollimit, duke ndërtua një strukturë moderne me qëllim që të krijojmë kushte sa më të mira për ushtarët, nënoficerët dhe për oficerët.

Gazeta "Forca Jonë": *FSK-ja rëndësi të veçantë po i kushton shkollimit të kadetëve të rinj, një sukses të jashtëzakonshëm arriti oficeri Ismajl Hoxha në Britani, çfarë do të thotë kjo për ju si Komandant i FSK-së?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama: E përmenda edhe më herët se ne kemi arrit të krijojmë standarde si në trajnime ashtu edhe në shkollim, si brenda institucionit dhe vendit tonë, po ashtu kemi arrit që të jemi pjesë e të gjitha akademive të vendeve më prestigjioze të shteteve anëtarë të NATO-s. Një prej rezultateve kulmore ishte shpallja e kadetit më të mirë në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Britaninë e Madhe e oficerit Ismajl Hoxha, që është nder dhe privilegj edhe për mua si Komandant, dhe lirisht mund të them se ky sukses është një histori në vete si për institucionin tonë ashtu edhe për Kosovën. Unë kam qenë i pranishëm në ceremoninë e diplomimit dhe personalisht e kam ndier vetën shumë krenar që e udhëheqë këtë institucion. Dhe mund të them lirisht se përpjekja jonë për arritjen e standardeve në fushën e shkollimit, përkatësisht në Qendrën për Studime Universitare, është kurorëzuar me sukses, ku edhe Ismajl Hoxha është produkt i kësajshkolle, i cili me suksesin e arritur e ka nderuar veten, familjen, institucionin ku ai shërben dhe gjithë Kosovën.

Gazeta "Forca Jonë": *Përveç të arriturave në shkollim dhe aktivitete humanitare FSK-ja ka kontribuar edhe nëçminimin e fushave të minuara si dhe vetëdijesimin e nxënësve përmes ligjëratave në shkolla?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Përgjegjësi e jona tash ligjore është, që ne të krijojmë ambient sa më të sigurt për qytetarët tanë. Ne kemi pastruar fusha të minuara me miliona metra katrorë, me qëllim që qytetarët tanë të jenë të sigurt. Të gjitha këto veprimet janë bërë me standarde dhe në bazë të planeve dhe afatet kohore. Gjatë periudhës dimërore pushojmë aktivitetet në fushat e deminuara dhe sipas planit vazhdojmë me organizimin e ligjëratave për vetëdijesimin e nxënësve dhe qytetarëve për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera. Ligjëratat zhvillohen sipas planit nëpër shkollat e Kosovës dhe në të gjitha ato zona ku kemi informacione që ka fusha të minuara, me përjashtim të pjesës veriore të Kosovës, ku shpresojmë që në një të ardhme të afër, me ndihmën e partnerëve tanë, do të jemi të pranishëm edhe në atë zonë të Kosovës.

Gazeta "Forca Jonë": *Çfarë ka bërë FSK-ja për integrimin e minoriteteve dhe a e keni plotësuar numrin e paraparë sipas përqindjes?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Unë realisht nuk jam ithtar i përqindjeve, por realisht ne kemi shifrën prej 9% të pjesëtarëve të minoriteteve në FSK. Mund të themi se është sukses që kemi një numër shumë më të madh të minoriteteve krahasuar me vitet e kaluara, e sidomos pjesëtarë të minoritet serb. Realisht për mua çdo qytetar i Kosovës që i plotëson të gjitha kriteret pa dallime do të jetë pjesë e Forcës. Falë angazhimit të përbashkët në këtë drejtim ne kemi arritur ta kemi një numër të caktuar të minoriteteve në FSK, po ashtu kemi arritet'i integrojmëedhe një numër të konsiderueshëmtëfemrave në të gjitha strukturat eFSK-së.



Gazeta "Forca Jonë": *A është e gatshme FSK të marrë përgjegjësi të reja?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Ne si FSK dhe si Ministri e Forcës i kemi kryer të gjitha obligimet tona ligjore. Është çështje politike se kur do të merret vendim për transformimin e FSK-sënë Forca të Armatosura të Kosovës. Unë, si Komandant i FSK-së, garantoj që FSK-ja është e gatshme të marrë përgjegjësi për kompetencat dhe detyrat e reja. Në këtëdrejtim i kemi detajuar të gjitha planet, qofshin ato afatmesme apo afatgjate të bazuara në standardet e NATO-s. Ne bashkëpunojmë me partnerët tanë strategjikë, por njëkohësisht i kemi edhe dy ekipe këshilluese të NATO-s, në Ministri edhe FSK, NAT-in dhe NLAT-in. Gjithçka që kemi ndërtuar deri me tani jemi bazuar në standardet e NATO-s, sepse qëllimi dhe synimi ynë është që të jemi pjesë e NATO-s.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janëplanet e Tuaja për të ardhmen?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Realisht ne do të vazhdojmë me punën tonë edhe në të ardhmen. Me kapacitete ekzistuese që i kemi do të vazhdojmë me ngritjen profesionale, sepse qëllimi ynë është arritja e standardeve të shteteve anëtare të NATO-s. Ne kemi misionin aktual dhe do të vazhdojmë punën në realizimin e detyrave. Kurdo që merret vendimi ne jemi të gatshëm ta ndryshojmë misionin tonë dhe të marrim kompetenca të reja.

Gazeta "Forca Jonë": *Zoti gjeneral cili është bashkëpunimi i FSK-së me mekanizmat ndërkombëtar të sigurisë si NATO, Garda Kombëtare e Ajovës etj. ,?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Ne kemi bashkëpunim bilateral me shumë shtete të regjionit dhe më gjerë, me të cilat kemi nënshkruar edhe memorandume bashkëpunimi. Bashkëpunim të mirë kemi me NATO-n, KFOR-in si dhe me Gardën Nacionale të Ajovës (SHBA). Kjo është një arritje e veçantë falë përkrahjes dhe mbështetjes që kemi nga partneri ynë strategjik Garda Kombëtare të Ajovës. Ne kemi zhvilluar mbi 40 aktivitete të përbashkëta qoftë në Kosovë qoftë në Ajovë, gjatë këtij viti. Dhe mund të them në bazë të vlerësimeve që kanë ardhur edhe nga SHBA-të është njëri ndër partnerët më të rëndësishëm që kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm. Bashkëpunim të mirë kemi me gjeneralin Orr i cili është shumë i angazhuar jo vetëm në fushën ushtarake por edhe fusha të tjera si p. sh në fushën e edukimit. Në fushën e edukimit kemi bashkëpunim të ngushtë edhe me partnerë të tjerë strategjik si me Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Turqinë. Po ashtu kemi nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi me vendet anëtare të NATO-s, kemi marrë pjesë në shumë ushtrime regjionale dhe kemi bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha vendet e regjionit.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është mesazhi juaj për qytetarët dhe pjesëtarët e FSK-së për festat e fundvitit ?*
Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Uroj të gjithë qytetarët e Kosovës e gjithashtu ushtarët dhe oficerët e FSK-së, për angazhimin dhe besimin e dhënë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. FSK-ja dhe gjithashtu Ministria e FSK-së, në të gjitha sondazhet që janë publikuar këto ditë, kanë dalë më të besueshmet për qytetarët e Kosovës. Kjo më gëzon për faktin se ne gjithmonë do jemi përkrahë tyre. Unë garantoj, që ne edhe në të ardhmen do të vazhdojmë me përkushtim që t'iu dalim në ndihmë të gjithë qytetarëve kurdo që ata kanë nevojë. Ky është misioni dhe detyra jonë. Ne do t'i respektojmë të gjitha vendimet që dalin, por garantojë që ne do të vazhdojmë rrugën tonë që ta arrijmë qëllimin qoftë nesër ose pasnesër, sepse është obligim i ynë kushtetues e ligjor.

Në Ministri të FSK-së u mbajt konferenca vjetore për media

FSK e gatshme për mision të ri dhe përgjegjësi të reja



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK) më 24. 12. 2015, u mbajt konferenca e fund vitit për media. Në Konferencë morën pjesë ministri i MFSK-së, Haki Demolli, Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministrat Fadil Gashi e MuhametLatifi, Sekretari i Përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NLAT) gjeneral brigade Stefan Fix, oficerë dhe zyrtarë të lartë të MFSK-së, FSK-së, përfaqësues të Ekipit Këshillues të NATO-s (NAT) dhe NLAT-it, dhe gazetarë të mediumeve të Kosovës. Ministri i FSK-së, zoti Demolli me këtë rast, i përshëndeti dhe falënderoi përfaqësuesit e mediave për përcjelljen korrekte dhe në mënyrë profesionale të aktiviteteve të FSK-së. Në fjalën e tij, Ai u ndal realizimi i objektivave dhe prioriteteve strategjike për këtë vit, të Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Si objektiv i parë, është ngritja dhe ndërtimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Kosovës, në bazë të rekomandimeve të dala nga Rishikimi i Strategjisë të Sektorit të Sigurisë të Kosovës. Objektivi i dytë, është hartimi dhe aprovimi i Pakos ligjore dhe dokumenteve strategjike të Mbrojtjes. Objektivi i tretë, është intensifikimi dhe sforcimi i bashkëpunimit bilateral me Forcat e Armatosura të SHBA-ve, vendeve të tjera të rajonit, NATO-n dhe BE-në. Objektivi i katërt, pjesëmarrja aktive dhe kontributi substancial në ndërtimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal dhe Objektivi i pestë, pjesëmarrja aktive dhe kontributi substancial në vendosjen e raporteve formale të bashkëpunimit të Republikës së Kosovës me NATO-n dhe BE-në. Ministri Demolli një rëndësie të veçantë i kushtoi bashkëpunimin me KFOR-in, të cilin e falënderoi për kontributin e dhënë në sigurinë e vendit. Ai foli edhe për bashkëpunimin bilateral me NATO-n, SHBA-të, si dhe shtetet tjera, sidomos theksoi bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Gradën Kombëtare të Ajovës, (SHBA). Në këtë takim në mënyrë të veçantë, Ministri Demolli theksoi punën e madhe që është bërë në kursimin e shpenzimeve të vetë Kabinetit të Ministrit, Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë. Me shifra të sakta, Ai u shpreh se në raport me shpenzimet e Kabinetit paraprak me vitin e kaluar, Kabineti i Ministrit ka bërë më pakë shpenzime për 81. 000 euro, kurse në nivel të Ministrisë dhe FSK-së janë bërë kursime deri në 701000 euro më pak se një vit më parë.

Në fjalën e tij Ministri Demolli posaçërisht falënderoi NATO-n, dhe mekanizmat e saj; NAT-in dhe NLAT-it, të cilët janë drejtpërdrejt të ndërlidhur në Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në. Një rëndësi të veçantë, Ministri Demolli tha I kemi kushtuar shkollimit të kadetëve dhe pjesëtarëve të FSK-së, në SHBA, Gjermani, Britani të Madhe, Kroacia, Maqedoni, Turqi etj. Ministri foli edhe për pjesëmarrjen në Konferencat ndërkombëtare dhe rajonale të Sigurisë, ku potencoi vizitat shumë të rëndësishme që zhvilloi në Bruksel dhe pjesëmarrjen në konferencat ndërkombëtare me karakter të sigurisë. Zoti Demolli falënderoi edhe të gjitha shtetet që po e ndihmojnë FSK-së, me donacione e në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po ashtu, ministri shprehu falënderimin dhe kënaqësinë për vlerësimin e lartë nga publiku i gjerë, në vlerësimet e opinionit publik të bëra nga tri OJQ-të kredibile, ku FSK-ja dhe MFK-ja, kanë dalë si institucionet më besueshme të vendit. Në fund, për sukseset e arritura, ministri falënderoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së; nga niveli i ushtarit e deri te komandanti si dhe personelin e MFSK-së. Gjatë konferencës për media, gazetarët parashtruan shumë pyetje që kishin të bënin me transformimin e FSK-së dhe sfidat. Ministri Demolli fjalën e tij para gazetarëve e përmbylli me konstatimin: "Ne jemi gati për misionin e ri, ne jemi gati për përgjegjësi të reja".

Një delegacion i Forcave të Armatosura të Kroacisë u prit nga Ministri i FSK-së Haki Demolli



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli, m2 dhjetor 2015, priti në takim një delegacion të ushtarakëve të lartë të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, të prirë nga komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (TRADOC), gjeneral brigade BlazBeretin. Gjatë takimit u bisedua për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë si dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe FSK-së, në kuadër të realizimit të aktiviteteve që dalin nga plani i aktiviteteve në kuadër të bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy ministrive tona. Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe i të dyja Forcave të të dy vendeve është jashtëzakonisht praktik, funksional dhe i sinqertë tha me këtë rast gjatë bisedës me mysafirët kroat, ministri Demolli. Ai gjithashtu përmendi edhe marrëdhëniet e mira ndërshtetërore të cilat kanë mundësuar edhe raporte shumë të mira ndërmjet institucioneve tona. Përkrahja dhe mbështetja ka rezultuar edhe si fryt i gatishmërisë për bashkëpunim të ministrit kroat të Mbrojtjes, AnteKotromanoviq, në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Njëherësh ministri i FSK-së gjatë bisedës me gjeneral Beretin shprehu mirënjohjen e tij të thellë për Forcat e Armatosura Kroate, të cilat ofruan mundësi për shkollimin e kadetëve dhe oficerëve tanë atje, si dhe për të gjitha kurset dhe trajnimet tjera të ofruara për kaq vite me radhë. Nga ana e tij, komandanti i TRADOK-ut, gjeneral brigade BlazBeretin tha se ndjehet jashtëzakonisht mirë që për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe kuadrot e saj kanë pasur mundësi të ofrojnë specializime dhe shkollime si dhe praktika, sepse siç tha Ai, populli i Kosovës e meriton dhe ne ju jemi mirënjohës për ndihmën dhe përkrahjen gjatë historisë së fundit të tyre. Gjenerali Beretin tha se kemi kënaqësinë që jemi këtu dhe se do të shohim nga afër qendrat tuaja trajnuese, shkollore dhe gjithë nevojat tuaja, në mënyrë që në të ardhmen të shqyrtojmë mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit, meqë siç tha Ai ekziston gatishmëri e madhe nga ana e palës kroate. Gjeneral brigade BlazBeretin sipas agjendës vizitoi edhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, ku do të shoh nga afër kapacitetet dhe punën që bën KDS-ja në drejtim të përgatitjes dhe profesionalizimit të pjesëtarëve të FSK-së. Gjatë takimit ministrin e FSK-së e shoqëruan, gjeneral brigade ZymerHalimi, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe kolonel Fadil Hadergjonaj, ndërsa nga pala kroate ishin edhe atasheu ushtarak i Kroacisë i akredituar në Kosovë, kolonel IvicaMateshiq, nënkolonel DragoIliq si dhe Nënkolonel Pero Matanoviq.

Shefi i Shtabit të Gardës Kombëtare të Ajovës vizitoi MFSK-në



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli, 2 dhjetor 2015, priti në takim shefin e Shtabit të Gardës Kombëtare të Ajovës, kolonel Michael G. Amundson. Gjatë takimit u bisedua për bashkëpunimin në kuadër të partneritetit shtetëror Kosovë- Aiovë, përkatësisht Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Garda Kombëtare e Aiovës. Gjithashtu u bisedua për planet e aktiviteteve, realizimin dhe planifikimin e aktiviteteve për të ardhmen, bazuar në planin e bashkëpunimit bilateral, si dhe për identifikimin e fushave në të gjitha nivelet si në atë taktik, operacional dhe strategjik, aty ku Ministria dhe FSK-ja kanë nevojë për mbështetje. Me këtë rast ministri Demolli, në emër të Ministrisë dhe FSK-së, i shprehu Shefit të Shtabit të Gardës së Ajovës, kolonelit Amundson dhe nëpërmjet tij edhe komandantit të Gardës, gjeneral major Timothy Orr, mirënjohjen dhe falënderimin për gjithë angazhimin që stafi komandues i Gardës, oficerët dhe nënoficerët e saj kanë bërë dhe po bëjnë që partneriteti në mes të dyja institucioneve të jetë kaq i sinqertë, i dobishëm dhe që premton të jetë i tillë edhe në të ardhmen. Gjithashtu edhe kolonel Amundson tha se ai ka qenë disa herë në FSK dhe se sa herë që ka ardhur ka parë ndryshime evidente, ndërsa kësaj here unë kam parë një progres fenomenal në shumë fusha dhe se me këtë vizitë dhe me aktivitetet që do të realizojmë këtu bashkë me juve ju garantoj se do të nxisin edhe fusha të reja bashkëpunimi, sepse ky zell dhe përkushtim e meriton angazhimin dhe vëmendjen tonë. Koloneli Amundson dhe ekipi i tij po qëndron këto ditë në FSK me qëllim realizimit të aktivitetit më të rëndësishëm për këtë vit në kuadër të bashkëpunimit dy palësh. Ky aktivitet do të fokusohet në shkëmbimin e informacioneve në lidhje me teknikat dhe doktrinën e Ushtrisë amerikane. Pos Ministrit Demolli në takimin e përbashkët ishin të pranishëm edhe gjeneral brigade ZymerHalimi, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve, kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim e Siguri si dhe Shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s, Dominic-HaydnBraithwaite dhe zëvendësi i tij kolonel Todd M. Jacobus.



Ministri Haki Demolli dhe ambasadorja e Turqisë Kivilcim Kiliç nënshkruan marrëveshje financiare

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli, më 10 dhjetor 2015,priti në vizitë ambasadoren e Republikës së Turqisë të akreditуar në Republikën e Kosovës, znj. KivilcimKilic. Ministri Demolli dhe ambasadorja e Turqisë nënshkruan marrëveshjen financiare për vitin 2015, me vlerë një milion dollarë. Kjo marrëveshje e cila nënshkruhet në fund të çdo viti, i hap rrugë realizimit të projekteve për pajisje, trajnime dhe çështje tjera, të cilat janë paraparë edhe në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Gjatë takimit ministri Dmolli i shprehu falënderim të veçantë ambasadores Kilic për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që Republika e Turqisë dhe Ministria e saj e Mbrojtjes kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin për Ministrinë dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu, ministri Demolli tha se e gëzon fakti se po përmbyllet edhe një vit i frytshëm bashkëpunimi në realizimin me sukses të projekteve në shumë fusha, si shkollim, trajnime etj. Ndërsa ambasadorja e Turqisë në Republikën e Kosovës, zonja KivilcimKiliç e rikonfirmoi gatishmërinë e Qeverisë së Turqisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes për mbështetje të vazhdueshme për Ministrinë dhe FSK-në, ashtu siç edhe është paraparë në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet dyja ministrive, asaj të Mbrojtjes të Turqisë dhe të FSK-së.

Komandanti i FSK-së gjeneral Rraham Rama vizitë zyrtare në Britani të Madhe

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Ministrit të Mbrojtjes të Britanisë së Madhe, nga data 07-12 dhjetor 2015, qëndroi për një vizitë zyrtare në Londër. Gjenerali Rrahman Rama gjatë vizitës në Londër u pritë në Ministrinë e Mbrojtjes, në Akademinë e Mbrojtjes, si dhe vizitoi edhe Parlamentin, ku pati takime pune me përfaqësues të këtyre institucioneve. Me këtë rast, komandanti i FSK-së falënderoi Qeverinë e Britanisë, si dhe Ministrinë e Mbrojtjes për të gjitha ndihmat e gjithanshme që ata po japin për FSK-në, si në shkollim dhe trajnime, me qëllim të ngritjes profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Gjatë takimeve që pati komandanti i FSK-së, gjeneral Rama në Londër, nga përfaqësuesit më të lartë shtetëror, mori premtime për përkrahje edhe në të ardhmen në të gjitha fushat, duke nënvizuar mbështetjen e vazhdueshme



për shkollimin e oficerëve të FSK-së. Vizita zyrtare e komandantit të FSK-së në Londër lidhet edhe me shkollimin e oficerëve të FSK-së në Akademinë Ushtarake të Britanisë së Madhe, ku gjeneral Rama do të marrë pjesë në ceremoninë e diplomimit të tre kadetëve të FSK-së në këtë Akademi. Akademia Ushtarake në Sandhurst është njëra ndër akademitë më të njohura në botë, me një traditë të gjatë shkollimi. Gjeneral Rama, gjatë vizitës së tij në Londër zhvilloi takime edhe në institucione tjera të Mbrojtjes.

Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Forcat e Armatosura të Turqisë thellojnë bashkëpunimin

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama me bashkëpunëtorë, me ftesë të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë(FAT) më 3 dhjetor 2015, qëndroi për një vizitë zyrtare në Ankara të Republikës së Turqisë. Fillimisht, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama u prit nga komandanti i Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneralin HulusiAkar. Gjatë bisedës, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e njoftoi gjeneralin Akar me të arriturat e FSK-së, zhvillimin dhe profesionalizimin e saj, duke u fokusuar në veçanti në realizmin e aktiviteteve që dalin nga Marrëveshja bilaterale e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë, përkatësisht në mes të dy Forcave. Gjeneral Rama me këtë rast u shpreh se Forcat e Armatosura të Turqisë janë partner i fuqishëm i FSK-së, të cilët gjatë këtyre viteve e kanë mbështetur zhvillimit e FSK-së në



fushën e shkollimit dhe trajnimeve si dhe me pajisje të ndryshme. Më tej gjeneral Rama e falënderoi gjeneralin turk për krijimin e mundësive që aktivitetet e parapara mbi bazën e planit të bashkëpunimit po realizohen me sukses, njëherësh ai shpreson se edhe aktivitetet e planifikuar për vitin tjetër dhe bashkëpunimi në mes të dy forcave të vazhdojë me të njëjtin intensitet. Gjithashtu edhe gjenerali turk HulusiAkan shprehu përkushtimin e vazhdueshëm të FA të Turqisë dhe të atij personalisht që edhe më tutje të vazhdohet dhe thellohet bashkëpunimi ndërmjet FA të Turqisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe ndërmjet dyja vendeve tona. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj gjatë qëndrimit në Turqi vizituan njësi dhe reparte të ndryshme të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama ligjëroi para studentëve të Kolegjit „Riinvest"

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka mbajtur ligjëratë para studentëve dhe profesorëve të Kolegjit „Riinvest" me temën „Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura". Në fillim Prof. Bardhyl Metaj para të pranishmëve bëri një prezantim për punën, jetën dhe shkollimin e Komandantit të FSK-së, si dhe kontributin e tij në periudha të ndryshme të jetës. Gjeneral Rama ligjëratën e tij e fokusoj në ndërtimin e FSK-së bazuar në ligjet të cilat dolën nga rekomandimet gjithëpërfshirëse të pakos së Ahtisarit, ku ndërtimin e FSK-së e mori përsipër NATO-ja, dhe kështu së bashku me një angazhim të përbashkët me partnerët për një kohë relativisht të shkurtër u arrit plotësimi i kritereve si arritja e kapaciteteve fillestare dhe më pastaj në korrik të 2013 rekomandimin nga sekretari gjeneral i NATO-s për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale, ato të Deminimit, Kërkim-Shpëtimit, Mbrojtjes Kimiko-Atomike Biologjike(MKAB), Logjistikës, Xhenios, Mjekësisë, Komunikimit, Policisë së Forcës etj. Pra, FSK-ja funksionon dhe vepron në linjë me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe bazuar në standardet e vëna nga NATO, tha gjeneral Rama, para studentëve. Gjeneral Rama mëtej shpjegoi strukturën e MFSK-së dhe FSK-së, trajnimet të cilat janë duke u



mbajtur si brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimin bilateral me Gardën Kombëtare të shtetit Ajova të SHBA-së, si dhe pjesëmarrjen në trajnimet dhe shkollat e NATO-s, nga ky vit. Gjatë ligjëratës, gjenerali Rama e theksoi edhe suksesin që pjesëtarët tregojnë gjatë studimeve jashtë vendit, duke theksuar suksesin e nëntogerit të FSK-së që ka përfunduar trajnimin në „Sundhurst" të Mbretërisë së Bashkuar duke u dekoruar si kadeti më i mirë. Më tej, Komandanti i FSK-së foli edhe për pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrimet regjionale si ai në Krivollakë të Maqedonisë, „JointReaction" në Shqipëri" dhe "ImmediateResponse", në Kroaci dhe Slloveni ku pjesëtarët e FSK-së kanë treguar një nivel të lartë të profesionalizimit në kryerjen e detyrave, dhe në vitin që po hymë siç tha ai kemi një ofertë për pjesëmarrje në një ushtrim në Poloni, ku do të marrin pjesë 21 shtete me mbi 25 000 ushtarë. FSK-ja ka realizuar me qindra projekte humanitare në të mirë të qytetarëve, ka deminuar mijëra metra katrorë fusha të minuara, me dhjetëra intervenime në shpëtim të jetës së qytetarëve nga ekipet e kërkim-shpëtimit. Pas rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë (RSSS) ku bëhet një analizë të gjithë sektorit të sigurisë për t`i analizuar sfidat e sigurisë të tashmes dhe të së ardhmes. FSK-ja ka përgatitur agjendën e transformimit së bashku me partnerët tanë kemi dorëzuar pakon e ligjeve për transformim jemi në pritje të një vendimi politik dhe ne jemi të gatshëm për misionin e ri që është Mbrojta e sovranitetit dhe integritetit territorial. Dhe kjo do të arrihet në fazat e zhvillimit të planifikuar në planin dinamik të transformimit, përfundoj gjeneral Rama, Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në fund nga studentët dhe profesorët u bënë pyetje të shumta të fokusuara në të arriturat, sfidat dhe mundësitë të cilat i ofron FSK-ja sot e në të ardhmen në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Oficeri i FSK-së, Ismajl Hoxha shpallet më i miri në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst të Anglisë

Pas 12 muajsh shkollim në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst në Britaninë e Madhe, oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ismajl Hoxha fitoi çmimin oficer-kadeti më i mirë ndërkombëtar, duke u bërë kështu oficeri i parë nga Ballkani që fiton një çmim të tillë. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama i shoqëruar edhe ambasadori i Kosovës në Londër, Lirim Grajçevci, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të kadetëve në Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst të Mbretërisë së Bashkuar. Me rastin e shpalljes së oficerit të



FSK-së, Ismajl Hoxha, kadeti me rezultatet më të larta nga oficer-kadetët ndërkombëtarë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se çmimi i sotëm dhe diplomimi i oficerëve të FSK-së ka rëndësi të veçantë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kosovën. "Po ndihem shumë i nderuar dhe i privilegjuar që jam sot këtu në cilësinë e komandantit. Është nder dhe është ngjarje historike edhe për Kosovën, por edhe për FSK-në, familjen dhe të gjithë ne", tha Ai. Oficerit të FSK-së Ismail Hoxhës gjatë ceremonisë i është dhuruar shpata si nderim për çmimin e fituar, pikërisht nga Princi Charles, i cili ka ndarë çmimet më të larta në emër të Mbretërisë së Bashkuar dhe Akademisë Mbretërore angleze. Princi Charli, para të pranishmëve në fjalën e tij, tha: "Sot është ditë feste për të kumtuar arritje të mëdha të njerëzve që meritojnë urimet më të ngrohta. Ju po merrni çmimet tuaja në një kohë kur profesioni ushtarak po zhytet në ujëra të turbullta. Shtyllat e rendit ndërkombëtar janë duke u sfiduar si kurrë më parë gjatë gjithë jetës time. Në të njëjtën kohë një kult vdekjeje dhe shkatërrimi është duke defiluar nëpër tokat e vjetra duke joshur një numër të frikshëm të të rinjve që përfundojnë të vdekur. Në ballë të këtyre sfidave, vlerat tradicionale britanike-sjellja e ndershme, qytetërimi, një dozë humori në vështirësi-mbesin po aq të çmuara siç kanë qenë gjithnjë", ka thënë Princi Charles. Ndërsa, kadeti më i mirë, oficeri





Hoxha, tha: "Nuk jam ndjerë asnjëherë më krenar dhe kaq i emocionuar. Kjo është një ditë e veçantë për mua. Ky titull është edhe një privilegj dhe obligim ma shumë që këtë ta dëshmojë me punë dhe angazhim më të madh, në të mirë të FSK-së dhe Kosovës". Bashkë me oficerin Hoxha diplomuan edhe dy oficerë të FSK-së, Fitore Fazliu dhe Besfort Kruma, të cilat ndiheshin krenarë që ishin pjesë e kësaj akademie. E veçanta e kësaj ceremoni ishte se flamuri i Kosovës ishte i pari nga të gjithë flamujt e shteteve tjera pjesëmarrëse në akademi, e jo sipas alfabetit, siç ka ndodhur në ceremonitë e kaluara. Në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst në Britaninë e Madhe në Londër edhe më parë kanë kryer studimet oficerë të FSK-së, të cilët gjithmonë janë dalluar me performancën e tyre. Në ceremoninë e diplomimit të oficer-kadetëve të Akademisë Mbretërore Ushtarake "Sandhurst" në Londër, e cila ka një traditë mbi 200 vjeçare, u certifikuan 120 kadetë, pas një shkollimi 12 muajsh.

FSK-ja dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë të gatshme të rrisin bashkëpunimin

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli priti në takim atasheun ushtarak të Republikës Federale të Gjermanisë, rezident në Bosnje dhe Hercegovinë i akredituar për Republikën e Kosovës, nënkolonel Martin Herrmann. Ministri Demolli dhe nënkolonel Herrmann me këtë rast nënshkruan amendamentet e memorandumit të bashkëpunimit të vitit 2014, në të cilën rregullohet dhe përcaktohet puna e këshilltarëve gjerman të cilët angazhohen me detyrën e këshilltarit për logjistikë në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në takim, ministri Demolli e falënderoi atasheun ushtarak të Gjermanisë për angazhimin e shtetit të Gjermanisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes në mbështetje për zhvillimin dhe avancimin profesional të FSK-së. Gjithashtu, ministri Demolli vlerësoi lart bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve dhe dy forcave, e me theks të veçantë përkrahjen që po jep Gjermania dhe Bundesveri gjerman në shkollimin dhe trajnimin e kuadrove, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së në Gjermani, pastaj trajnime brenda vendit duke e potencuar edhe punën e oficerit-këshilltarë për Logjistikë në MFSK, i cili është i angazhuar që nga viti 2014. Nga ana e tij, koloneli Herrman, rikonformoi edhe një herë se Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë janë të gatshme të thellojnë dhe rrisin fushat e bashkëpunimit në të ardhmen. Në takimin të pranishëm ishin edhe kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim ndërkombëtarë si dhe oficeri gjerman, nënkolonel MichaelGierse, këshilltar në Departamentin e Logjistikës në MFSK.



Ministri Haki Demolli priti ambasadorin e Kanadasë Daniel Maksymiuk

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli më 10 dhjetor 2015, priti për vizitë zyrtare ambasadorin fuqiplotë të Mbretërisë së Kanadasë, rezident në Republikën e Kroacisë, i akredituar për Republikën e Kosovës, z. DanielMaksymiuk. Ministri Demolli, fillimisht, në emër të Ministrisë dhe FSK-së i shprehu mirëseardhjen dhe falënderimin ambasadorit Maksymiuk për gjithë angazhimin dhe mbështetjen që shteti mik i Kanadasë i ka ofruar shtetit të Kosovës në gjitha periudhat e vështira të saj si dhe për interesimin dhe gatishmërinë e vazhdueshme për të qenë afër dhe e gatshme për ta përkrahur Kosovën në rrugën e saj drejt zhvillimit dhe aspiratës euroatlantike. Ministri Demolli në takim i shprehu ambasadorit kanadez mirënjohje për ftesën, pritjen si dhe për ofrimin e takimeve dy dhe shumë paleshë



me Ministrin e Mbrojtjes të Kanadasë e ministra tjerë të Mbrojtjes, pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare për Siguri dhe mbrojtje që u mbajt në Halifaks të Kanadasë muajin e kaluar. Më tej Ministri Demolli pasi e njoftoi mysafirin e lartë, ambasadorin e shtetit mik të Kanadasë mbi zhvillimin e FSK-së, planet për të ardhmen i shprehu interesimin dhe përkushtimin që MFSK-ja dhe Ministria e Mbrojtjes së Kanadasë të punojnë në drejtim të arritjes së marrëveshjes së bashkëpunimit, si akt zyrtar që rregullon dhe precizon fushat e bashkëpunimit për të ardhmen. Nga ana e tij ambasadori i Kanadasë, z. DanielMaksymiuk u shpreh se shteti i Kanadasë është shumë i gatshëm që ta vazhdojë dhe thellojë bashkëpunimin me Republikën e Kosovës, e konkretisht me MFSK-në dhe FSK-në. Ambasadori Maksymiuk konfirmoi gjithashtu edhe mbështetjen e Kosovës në përpjekjet dhe rrugën e saj për anëtarësim dhe integrim euroatlantik.

Donacion nga SHBA-të për Kompaninë e Deminimit të FSK-së

Në kazermën e Kompanisë së Deminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civiletë FSK-së, në Prizren u mbajt ceremonia e certifikimit të trajnerëve për Deminim, Eliminim të Mjeteve të Pashpërthyera (EOD) dhe pastrim të fushëbetejave (BAC), si dhe u zhvillua dorëzim- pranimi i një donacioni me pajisje specialistike për operacione të deminimit, dhuruar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, në vlerë prej afër 200 mijë euro. Në ceremoni ishin të pranishëm ministri i MFSK-së Haki Demolli, komandanti i FSK-së, Gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i SHBA-ve, në Prishtinë, z. GregoryDelawie, zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i RMC-së kolonel ShaipHaziri, shefi i ODC (Zyra për Bashkëpunimin Ushtarak e Ambasadës Amerikane) kolonel Jerzy S. Zubr, si dhe instruktorët amerikanë dhe deminerët e FSK-së. Me këtë rast, ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli fillimisht falënderoi SHBA-të dhe Ambasadën Amerikane në Kosovë për donacionin dhe mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së, në ngritjen e kapaciteteve dhe përmbushjen e misionit të saj në mënyrë efikase. Ai, me këtë rast, shtoi se ekzistimi i zonave të minuara dhe mjeteve të pashpërthyera në zonat e prekura nga to, nuk përbën vetëm një rrezik për jetën e njerëzve e banorëve, por e rëndon edhe gjendjen ekonomike të tyre për shkak të pamundësisë së punimit të tokave bujqësore dhe shfrytëzimit të produkteve malore. Mënjanimi i rrezikut nga minat dhe mjetet e pashpërthyera është parakusht për rindërtimin e vendit dhe shfrytëzimin e resurseve të saja natyrore. Për këtë, njësitë e deminimit të FSK-së, jo vetëm që na bëjnë krenarë, por tregojnë edhe punën e shkëlqyer që kanë kryer, nga e cila punë janë shpëtuar shumë e shumë jetë njerëzish. Në tersi, që nga viti 1999 e këndej nga minat dhe mjetet tjera shpërthyese janë pastruar mbi 50 milion metra katrorë sipërfaqe dhe janë gjetur mbi 90 mijë mina dhe mjete të pashpërthyera. I tërë ky sukses nuk do të ishte i mundshëm pa ndihmën e miqve tanë nga SHBA-të, të cilët kanë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme



në këtë fushë, si me trajnime, pajisje e mbështetje tjera, që është një kontribut i jashtëzakonshëm për FSK-në, sepse deminimi është njëra prej veprimtarive themelore të FSK-së. Në fund, ministri Demolli falënderoi edhe instruktorët amerikanë, ndërsa pjesëtarët e sapocertifikuar të FSK-së, i përgëzoi që vazhdimisht po kryejnë një mision sa fisnik po aq edhe human. Ndërsa, ambasadori i SHBA-ve në Prishtinë, z. GregoryDelawie tha se jam i nderuar që po marrë pjesë në këtë ceremoni të certifikimit pas trajnimit trajno-trajnerët si dhe aftësimin e tyre për përdorimin e pajisjeve specialistike. Jam i nderuar që në emër të Ambasadës Amerikane dhe Qeverisë Amerikane për FSK-në t'i dhuroj FSK-së, këto mjete specialistikeme qëllimin që këto mjete të lehtësojnë punën e deminierëve në terren në mënyrë që Kosova të jetë e sigurt për qytetarët e saj. Donacioni në vlerë prej afër 200 mijë dollarëve është siguruar nga programi për ndihma i Komandës së SHBA-ve për Evropë.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral Rama priti profesorë dhe studentë të Kolegjit AAB

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama takoi një grup mësimdhënësish dhe studentësh të Kolegjit AAB, të cilët kishin shprehur dëshirën që të vizitonin Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe të njihen për së afërmi me të. Fillimisht, gjeneral Rama falënderoi studentë dhe profesorët për interesimin e tyre për FSK-në. Më pas, gjeneral Ramai njoftoi studentët për sukseset e arritura në zhvillimin e FSK-së, për bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtarë, për partneritetin e ndërtuar me disa prej vendeve anëtare të NATO-s e më gjerë. Ai po ashtu i njoftoi me ngritjen profesionale, trajnimin dhe shkollimin, pajisjet si dhe për të ardhmen e FSK-së, si institucion i cili çdo herë është e gatshme për t'iu dalë në ndihmë institucioneve tjera dhe qytetarëve të vendit tonë, por edhe



më gjerë, në rajon, atëherë kur kjo kërkohet nga Forca e Sigurisë dhe kur institucionet më të larta vendosin për këtë. Gjeneral Rama foli gjithashtu edhe për arritjet në përfshirjen e femrave dhe të minoriteteve në FSK, e sidomos potencoi angazhimin e pjesëtarëve të FSK-së në pastrimin e fushave të minuara, në operacionet e kërkimit për personat e humbur(aksidentuar), pastaj edhe për sukseset e kadetëve dhe pjesëtarëve tanë kudo ku shkollohen e trajnohen jashtë vendit, siç ishte rasti kur këtë muaj oficeri i FSK-sëIsmajl Hoxha zuri vendin e parë nëAkademinë e Sundhurst në Londër. Komandanti i FSK-së, në përgjigje të pyetjeve të shumta të shtruara nga të pranishmit tha se ne e kemi obligim kushtetues dhe mision që të punojmë pa reshtur që të ngritimnjë institucion i cili u del në ballë nevojave dhe kërkesave të qytetarëve të vendit tonë, si dhe angazhim në ngritjen e një force profesionale dhe të besueshme. Ndërsa, lidhur me strukturën, organizimin misionin dhe planifikimin për transformimin e FSK-së në FAK, për të pranishmit bëri një prezantim shefi i Departamentit për Bashkëpunim ndërkombëtarë, kolonel Ilir Qeriqi, i cili i njoftoi studentët dhe mësimdhënësit e Kolegjit AAB përstrukturën, misionin dhe detyrat e forcës, misionin e njësive, vendbazimet, si dhe me disa prej operacioneve më të suksesshme të FSK-së gjatë veprimit të saj. Në fund përfaqësuesit e Kolegjit AAB falënderuan komandantin e FSK-së për pritjen dhe u shprehën mirënjohës për informacionet të cilat patën mundësi t'i marrin këtu, e që do t'ju nevojiten gjatë formimit të tyre të përgjithshëm akademik dhe profesional.

Plani i ngritjes së integritetit bashkon përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare

Nën kryesimin e drejtorit të Drejtorisë për Politika dhe Plane të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Faruk Geci dhe me organizim të Qendrës Kombëtare për Studime të Sigurisë në Prishtinë, u mbajt takimi në kuadër të projektit Ngritja e Planit të Integritetit. Në takim morën pjesë edhe drejtorë të departamenteve të MFSK-së, drejtori i QKSS, Florian Qehaja, shefi i Ekipit Këshillues të NATO-s për MFSK-në, DominicBraudwait, drejtori i Agjencisë së Kosovës kundër Korrupsionit, HasanPreteni si dhe përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes të Norvegjisë dhe përfaqësues nga Mali i Zi. Hartimi i Planit të Integritetit është realizuar në kuadër të "Projekti 6" dhe është sponsorizuar nga Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë.

FSK-ja përfundoi me sukses operacionet e deminimit humanitar për vitin 2015

Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Kompania e Deminimit (KD) e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO), me datë 27 nëntor 2015 ka përfunduar me sukses sezonin e deminimit humanitar dhe të pastrimit të fushëbetejave, sipas planit të veprimit, pa asnjë incident. Sipas raportit të Qendrës Koordinuese për Deminim në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nga 1 prilli dhe deri më 27 nëntor, kanë qenë të angazhuar çdo ditë pune në terren dhe sipas prioritetit kanë punuar pandërprerë në këto lokacione: Seçishtë, Ferizaj, ,,Parku Liria" Ferizaj, Luzhnicë, Zagerm dhe Gorancë. Gjatë kësaj periudhe tetë mujore, pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit nuk kanë pësuar asnjë lëndim as edhe nuk kanë pësuar as një incident. Kjo tregon për shkallën e lartë të përgatitjes morale, fizike dhe profesionale të deminierëve tanë. Me punë profesionale, përkushtim dhe disiplinë maksimale, deminierët e FSK-së kanë arritur që këtë vit të çminojnë sipërfaqen prej 282 mijë e 985 metër katror dhe kanë demoluar 440 mjete eksplozive të pashpërthyera (mina të vendosura nga dora e njeriut), si dhe pastrim të fushëbetejave (sipërfaqe dhe hapësira të bombarduara nga ajri). Përveç deminimit humanitar dhe pastrimit të fushëbetejave, Kompania e Deminimit ka edhe Njësitë për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera (EOD), të cilat gjatë këtij viti deri më tani kanë intervenuar sipas thirrjes në 301 raste, si dhe kanë demoluar 441 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera. Vlen të theksohet se Ekipet e EOD-së janë në gjendje gatishmërie 24 orë në ditë, gjatë 7 ditëve të javës, për gjatë gjithë vitit në dy kazerma të FSK-së, në Prizren dhe në Pomozoton, si dhe aktivizohen për veprim sipas thirrjes së Policisë së Kosovës. Me përfundimin e sezonit të deminimit humanitar dhe pastrimit të fushëbetejave, Kompania e Deminimit sipas planit zhvillon trajnime rifreskuese profesionale për pjesëtarët e saj, pra për deminierët, në mënyrë që ata të mbajnë dhe zhvillojnë edhe me tutje



përgatitjen profesionale të tyre për punë në terren duke ditur se është punë mjaft delikate dhe me përgjegjësi. Gjithashtu, Kompania e Deminimit gjatë sezonit dimëror zhvillon aktivitete vetëdijesimi me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës, me qëllim të ndërgjegjësimit të tyre për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera eksplozive të pashpërthyera.

Certifikohen 18 pjesëtarë të FSK-së për procesin e vendimmarrjes

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt ceremonia e certifikimit të 18 oficerëve dhe nënoficerëve pjesëtarë të shtabeve dhe batalioneve të FSK-së, të cilët kryen një trajnimin treditor "Procesi i Vendimmarrjes Ushtarake" nga një ekip ekspertësh të Komandës së Marinës Amerikane për Evropë (MARFOREUR). Në ceremonii pranishëm ishte zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gazim Hazrolli, shefi i Departamentit të Operatives,kolonel Bashkim Shillova dhe rreshter majorin e KFT-së, FetahZejnullahu. Me këtë rast, gjenerali Gëzim Hazrolli falënderoi ekipin e instruktorëve për këtë bashkëpunim "Kam kënaqësinë të marrë pjesë në këtë ceremoni pothuajse në përmbyllje të një viti mjaft të suksesshëm për FSK-në, dua të falënderoj Ushtrinë Amerikane në përgjithësi, e në veçanti përshëndes instruktorët të cilët gjetën kohë të ndajnë më pjesë-



tarët tonë eksperiencën të tyre të madhe në procesin e vendimmarrjes, proces mjaft i rëndësishëm për një ushtarak i cili të përcjellë gjatë tërë jetës, siç thuhet: Profesioni i ushtarakut është arti, e arti flenë në procesin e vendimmarrjes". I kënaqur nga ky bashkëpunim u nda edhe instruktori amerikan kapiten SUMPTION " Jam shumë i kënaqur që më është dhënë mundësia të bashkëpunoj me ju. Kemi kalua ditë mjaft të mira bashkë dhe jam i impresionuar nga interesimi i të gjithë pjesëtarëve. Gjatë këtyre ditëve patëm mundësinë që të shkëmbejmë idetë tona më ç'rast ne arritëm të mësojmë mjaft nga ju e që shpresoj që edhe ju keni përvetësuar nga eksperiencat tona". Ky trajnim u realizua duke u bazuar në planin e bashkëpunimit bilateral me SHBA-të, me qëllim të familjarizimit të pjesëtarëve të FSK-së, në nivel të batalionit dhe komandantëve të kompanive për procedurat e vendimmarrjes.

Xhenierët e FSK-së rregullojnë oborrin e shkollës në fshatin Batllavë

Batalioni i Xhenios i Brigadës së Mbështetjes Operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ditë më parë, ka përfunduar projektin humanitar për rregullimin e oborrit të Shkollës Fillore të Mesme e Ulët "Luigj Gurakuqi" në fshatin Batllavë të Komunës së Podujevës. Ky projekt është realizuar në kuadër të Planit të Veprimit për vitin 2015, të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe bashkëpunimit me komunat e Kosovës. Batalioni i Xhenios e ka filluar realizimin e projektit më 17 nëntor 2015 dhe e ka përfunduar më 25 dhjetor 2015. Në projekt janë angazhuar gjithsej 10 pjesëtarë me tetë automjete, ndërsa Komuna e Podujevës i ka hequr shpenzimet e derivateve. Batalioni i Xhenios është angazhuar në realizimin e operacioneve humanitare, bazuar në planifikimet dhe kapacitetet e kësaj njësie, dhe në qëllimet e komandantit për t'iu ofruar ndihmë të gjitha komuniteteve në rregullimin e infrastrukturës për një jetë më të mirë dhe ambient të qetë.



Batalioni i Dytë i Reagimit të Shpejtë realizoi ushtrimin fushor "Ujku në Veprim"



Pjesëtarët e Batalionit të Dytë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë (Kompania 2 B) në Istog, pas përfundimit të trajnimit tremujor, më 11 dhjetor 2015, finalizuan ushtrimin fushor 48 orësh në terren të koduar "Ujku në Veprim" në lokalitetin e Istogut. Për ta përcjellë nga afër ushtrimin fushor "Ujku në Veprim" të pranishëm ishin: komandant i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, komandanti i Batalionit të Dytë, nënkolonel MehmetLladrovci, ekipet e Komandës së Batalionit të Dytë dhe ekipet vlerësuese në kuadër të BRSh-së. Pas përfundimit të ushtrimit u vlerësua lart realizimi, njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga pjesëtarët e Batalionit të Dytë, ku dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht për planifikim dhe operacione ushtarake. Ky trajnim ishte planifikuar dhe realizuar në bazë të Planit vjetor të trajnimit dhe aktiviteteve të Batalionit të Dytë, Listës së detyrave esenciale për zbatimin e misionit dhe Planit vjetor të aktiviteteve të BRSH-së.

FORCA JONË

□□□ Viti V □ Nr. 43 □shkurt 2016 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Ministri Haki Demolli priti asistentin për operacione të Sekretarit gjeneral të NATO-s, Patrick Turner

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli me bashkëpunëtorë, më 29 janar 2016, priti në takim asistentin për operacione të Sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, z. Patrick Turner. Fillimisht, ministri Demolli në emër të Ministrisë dhe FSK-së e falënderoi përfaqësuesin e NATO-s për kujdesin dhe angazhimin që ka treguar NATO-ja përmes KFOR-it për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Republikën e Kosovës. Ai po ashtu falënderoi edhe dy ekipet këshillëdhënëse (Ekipin Këshillues të NATO-s për Ministrinë (NAT), dhe Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në (NLAT), të cilat Pakti Veri-Atlantik i ka ofruar në mbështetje të Ministrisë dhe FSK-së. Ministri Demolli gjatë takimit e njoftoi z. Turner lidhur me bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të FSK-së me KFOR-n në një varg operacionesh të përbashkëta, siç janë kërkim- shpëtimi në lumin Ibër, ndërtimi i urës tek Manastiri i Deçanit, operacioni i zjarrfikjes në pyjet e Dragashit, e një sërë aktivitetesh tjera në të mirë të popullatës së Kosovës. Gjithashtu ai foli edhe për rëndësinë e takimeve me komandantin e KFOR-it, gjeneral Guglielmo Luigi Miglietta, për harmonizimin e



aktiviteteve të përbashkëta për të ardhmen dhe për angazhimin e tij rreth procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës(FSK). Ministri Demolli i shprehu asistentit të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s vizionin e Republikës së Kosovës për stabilitet në vend, rajon dhe më gjerë, e në veçanti ritheksoi aspiratën e vendit tonë për anëtarësim në NATO dhe integrim në Bashkimin Evropian. Ai shfaqi interesimin e tij që marrëdhëniet në mes Kosovës dhe NATO-s të thellohen nëpërmjet vendosjes së një dialogu politik në nivel ministror. Thellimi i këtyre marrëdhënieve, nëpërmjet hapjes së një zyre ndërlidhëse në mes të Republikës së Kosovës dhe NATO-s, si dhe shtimi i pranisë civile të NATO-s në Kosovë do të ishte thelbësore në prag të transformimit të FSK-së në FAK, theksoi Ministri Demolli. Ministri i FSK-së e njoftoi z. Turner edhe me fazën në të cilën ka arritur procesi i transformimit, duke shprehur kështu edhe vizionin e tij për ndërtimin dhe zhvillimin e një Force profesionale me kritere dhe standarde të NATO-s. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Krahman Rama, gjatë këtij takimi tha se Forca e Sigurisë është e gatshme të mbështesë autoritetet civile dhe të gjithë qytetarët e vendit pa dallim, dhe se FSK-ja është e interesuar që t'i zhvillojë edhe më tutje kapacitetet e saj. Ai foli edhe për përgatitjet rreth procesit të transformimit: "Ne kemi punuar ngushtë me DIR-in nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës(ShBA), si dhe me ekipet e NATO-s, NAT dhe NLAT. Si rezultat i kësaj pune të përbashkët ne tani kemi një draft plan final të transformimit. Në këtë draft plan janë paraparë personeli, pajisjet si dhe buxheti, përfshirë këtu edhe buxhetin shtesë. FSK-ja është e gatshme të fillojë me procesin e transformimit kurdo që vendimmarrësit politikë vendosin për këtë".

(vijon në faqen 2)

ShBA-të ndihmojnë FSK-në me mbi 9.2 milionë dollarë

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Bilateral me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Zyra për Bashkëpunim e Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë, në muajin janar 2016 ka nënshkruar edhe një marrëveshje për përkrahje financiare për vitin 2016 me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Marrëveshjen në emër të Qeverisë së SHBA-së e ka nënshkruar drejtori DSCA EUCOM- AFRICOM, Reg Opns, kolonel David Bennett, kurse në emër të MFSK-së e ka nënshkruar sekretar i përgjithshëm, z. Shkëlzen Sylaj. Donacioni për vitin 2016 kap vlerën prej 9,138,497.00$ dhe është një përkrahje e radhës që SHBA-të po japin për Kosovën e në veçanti për FSK-në. Sipas planifikimit ky donacion do të realizohet gjatë vitit 2016, ndërsa këto mjete do të përdoren për zhvillim profesional të pjesëtarëve të FSK-së, rritjen e operacionalitetit të njësiteve të FSK-së, respektivisht për pajisjen e njësiteve të FSK-së me radiolidhje taktike, si dhe për ngritjen e rrjetit strategjik të komunikimit. Falë ndihmës së vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, FSK-ja po i ngrit kapacitetet e saj operacionale, duke realizuar trajnime specialistike në të gjitha njësitet e saj.

Komandanti i FSK-së takoi admiralin Ferguson

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 26 janar 2016, priti në një takim pune komandantin e Forcave të Përbashkëta të Napolit, admiralin e Flotës Ushtarake Detare të SHBA-ve, Mark E. Ferguson III. Gjeneral Rama falënderoi admiralin Ferguson për ndihmën e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës po japin për Kosovën e në veçanti për Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke theksuar bashkëpunimin e mirë me Gardën Kombëtare të Ajovës. Me këtë rast, komandant Rama vlerësoi lart edhe bashkëpunimin e mirë të FSK-së me KFOR-in. Më pastaj, komandanti i FSK-së e njoftoi admiralin Ferguson për të arriturat e FSK-së në të gjitha fushat, për bashkëpunimin e saj me shtete të ndryshme,pjesëmarrjen në ushtrime dhe trajnime regjionale



dhe ndërkombëtare, si dhe për zhvillimet aktuale në FSK, duke u fokusuar tek procesi i transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës. Nga ana e tij, admirali Ferguson u shpreh i kënaqur me vizitën e tij në FSK, duke theksuar edhe një herë se SHBA-të do të vazhdojnë ta ndihmojnë FSK-në edhe në të ardhmen. Në këtë takim komandantin e FSK-së e shoqëruan gjeneral brigade Zymer Halimi, kolonel Ilir Qeriqi dhe Major Berat Shala, ndërsa admirali Ferguson ishte i shoqëruar nga komandanti i KFOR-it, gjeneral-major Guglielmo Luigi Miglietta, koloneli Kay Hasson, zoti Xhef Firing (Jeff Fearing) si dhe nga zyrtarë dhe oficerë të tjerë të lartë.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli mbajti fjalën tematike në Akademinë Përkujtimore për Zahir Pajazitin, Hakif Zejnullahun dhe Edmond Hoxhën



Në 19-vjetorin e rënies së dëshmorëve të kombit: Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu, në Prishtinë nën patronazhin e Kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, u mbajt Akademi Përkujtimore. Të pranishëm në akademi ishin familjarë të dëshmorëve, bashkëluftëtarë, qytetarë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama dhe shumë drejtues e përfaqësues të institucioneve shtetërore të Kosovës. Në emër të institucioneve të Kosovës, për veprën dhe shëmbëlltyrën e tre dëshmorëve, foli ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, i cili tha se, më 31 janar të vitit 1997, në një pritë të Policisë së Serbisë në fshatin Pestovë të Vushtrrisë u vranë tre dëshmorët e kombit, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha. "Duke qenë përherë në shërbim të atdheut dhe të idealeve për çlirimin e vendit, më 31 janar të vitit 1997, Zahir Pajaziti, gjatë udhëtimit nga Prishtina në drejtim të Vushtrrisë, i shoqëruar nga bashkëluftëtari dhe nipi i tij, Hakif Zejnullahu, si edhe nga bashkëluftëtari tjetër Edmond Hoxha nga Juniku, bien në pritën e forcave ushtarako-policore serbe në fshatin Pestovë të Vushtrrisë. Pas një përleshjeje të armatosur me forcat policore serbe, të cilat për nga numri ishin dhjetëra herë më të mëdha, të tre trimat kosovarë bien heroikisht në krye të detyrës, në luftën për çlirimin e atdheut", tha Demolli. "Rënia e tyre ishte një humbje e madhe për Ushtrinë Çlirimtare, por në të njëjtën kohë ishte një frymëzim i jashtëzakonshëm për grupet e para të UÇK-së. Rënia e tyre ishte një rënie paralajmëruese e cila shërbeu si një frymëzim për rininë kosovare që t'i bashkëngjiten radhëve të forcave që luftonin për lirinë e atdheut", theksoi ai. Ministri Demolli tha se Zahiri, Hakifi dhe Edmondi sot gëzojnë mirënjohjen e popullit të Kosovës për lirinë e të cilit u flijuan ata. "Sot, kur Kosova dhe populli i saj jeton dhe frymon në lirinë e fituar me angazhimin dhe veprimtarinë patriotike të Zahirit, Hakifit, Edmondit dhe të gjithë heronjve tanë të lirisë, ne përulemi para jetës dhe veprës së tyre, duke u premtuar se përherë do të jemi mirënjohës dhe do të vlerësojmë përjetësisht kontributin, sakrificën dhe gjakun e tyre të derdhur për lirinë e vendit", theksoi ministri i FSK-së, Haki Demolli. Ministri i FSK-së, Haki Demolli, është i bindur se Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës gjatë këtij viti do të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore dhe kushtetuese për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. "Jam thellësisht i bindur se Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, në vazhdën e angazhimit për konsolidimin e organeve të veta më vitale shtetërore, gjatë këtij viti do të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore dhe kushtetuese për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Forcat e Armatosura të Kosovës përveç mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit të vendit tonë, objektivë tjetër madhore do të kenë edhe anëtarësimin në NATO, si dhe gatishmërinë për pjesëmarrje në misione paqeruajtëse dhe humanitare në vende të ndryshme jo vetëm në Evropë, por edhe më gjerë. Përmbushja dhe realizimi i këtyre objektivave të Forcave të Armatosura të Kosovës paraqet plotësimin e një dëshire jo vetëm të popullit të Kosovës, por edhe të Zahirit, Hakifit, Edmondit dhe të gjithë luftëtarëve, dëshmorëve dhe heronjve të vendit tonë", tha Demolli në Akademinë Përkujtimore të organizuar me rastin e përvjetorit të rënies heroike të Heronjve të Kosovës, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha.

Ministri Haki Demolli priti asistentin për operacione të Sekretarit gjeneral të NATO-s, Patrick Turner

(Vijon nga faqja parë)

Në fund, gjeneral Rama u shpreh se FSK-ja është e gatshme që me kapacitetet e saj të marrë pjesë në operacione të përbashkëta si kontribuuese në ruajtjen e paqes kudo ku paraqitet nevoja, duke e garantuar asistentin e Sekretarit të përgjithshëm të NATO-s se FSK-ja do të jetë transparente dhe bashkëpunuese me Qeverinë e vendit, NATO-n dhe partnerët strategjikë gjatë procesit të transformimit.

Nga ana e tij, z.Patrick Turner duke shprehur kënaqësinë për vizitën që i bëri Republikës së e Kosovës e në veçanti MFSK-së dhe FSK-së, tha se i gëzohet nivelit të bashkëpunimit të MFSK-së dhe FSK-së me KFOR-in dhe me dy trupat e NATO-s këtu, NAT dhe NLAT, mekanizma këta që së shpejti do të shkrihen në një të vetëm dhe se do të vazhdojnë të qëndrojnë këtu. Asistenti për operacione i Sekretarit të NATO-s, z. Turner nënvizoi faktin se aktualisht qëllimi i NATO-s është që KFOR-i në Kosovë të vazhdojë ta mbajë këtë numër dhe këto kapacitete, duke theksuar se misioni i NATO-s në Republikën e Kosovës është misioni i dytë më i madhi për nga numri. Në vijim, PatrickTurner duke folur për planin afatgjatë të NATO-s tha se NATO-ja është e interesuar të qëndrojë këtu, në mënyrë që rajoni i Ballkanit të jetë i stabilizuar dhe i integruar dhe se Kosova e meriton të jetë pjesë e familjes euro-atlantike. Në takim nga MFSK-ja ishin të pranishëm edhe zëvendësministri MuhametLatifi, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, si dhe këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Fadil Hadergjonaj, ndërsa nga delegacioni i NATO-s, ishin drejtori i NAT-it, Dominic-Haydn Braithwaite, drejtori i NLAT, gjeneral Stefan FIX, znj. Silvia Maretti, oficere për stafin ndërkombëtar dhe z. Carlo Giunipero.



Gjenerallejtënant Rrahman Rama ligjëroi në Kolegjin "Juridica"

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 15 janar 2016, para një grupi të profesorëve dhe studentëve të Kolegjit Evropian "Juridica", mbajti ligjëratën me temën "Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës". Ligjëratën e hapi dekani i Kolegjit Evropian "Juridica " Prof. As. Dr. Agron Beka. Me këtë rast shefi i FSK-së foli për strukturën e MFSK-së dhe FSK-së, kapacitetet operacionale, vendbanimet, aktivitetet humanitare si dhe trajnimet të cilat janë duke u mbajtur brenda dhe jashtë vendit, duke filluar nga ShBA-ja me bashkëpunimin bilateral me Gardën Kombëtare të shtetit IOWA të ShBA-së, pjesëmarrjen e pjesëtarëve të FSK-së në trajnimet dhe shkollat e NATO-s. Gjatë ligjëratës, komandanti i FSK-së theksoi edhe suksesin që po tregojnë pjesëtarët e kësaj force gjatë studimeve të tyre jashtë vendit, duke cekur shembullin e nëntogerit të FSK-së, i cili ka përfunduar trajnimin në SANDHURST të Mbretërisë së Bashkuar duke u dekoruar si kadeti më i mirë. Rama po ashtu veçoi edhe punën që bëjnë ekipet e deminerëve të FSK-së, duke çminuar me mijëra metra katrorë në vit në vende të minuara, dhe pa pasur as më të voglin incident me çka tregohet puna, përkushtimi dhe profesionalizmi që kanë pjesëtarët e FSK-së. Gjeneral Rama një pjesë të ligjëratës e përqendroi në përgatitjet të cilat janë bërë për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, pas rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë dhe analizës që i është bërë gjithë sektorit të sigurisë, për t`i analizuar sfidat e sigurisë të tashmes dhe të së ardhmes, si rreziqet e brendshme ashtu edhe ato të jashtme. Mbi bazën e rekomandimeve të këtij rishikimi është planifikuar krijimi i Forcave të Armatosura me mision të ri: mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit; mbështetje autoriteteve civile; mbështetje komuniteteve; pjesëmarrje në operacione paqeruajtëse ndërkombëtare. Mbi bazën e këtyre detyrave thelbësore është punuar dhe planifikuar edhe struktura e Forcave të Armatosura të Kosovës. Pas përfundimit të ligjëratës të pranishmit parashtruan pyetje të ndryshme rreth bashkëpunimit bilateral, strukturës gjinore, pajisjeve, misionit dhe detyrave të Forcave të Armatosura.



Ministri dhe Komandanti i FSK-së në zbulimin e pllakës përkujtimore për ushtarët sllovakë të KFOR-it

Ministri i FSK-së, Haki Demolli dhe gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i FSK-së, vendosin kurora me lule në Pllakën Përkujtimore në Gërmi, në nderim të ushtarëve sllovakë, të cilët kishin shërbyer në kuadër të KFOR-it në Kosovë. 43 ushtarët sllovakë humbën jetën në një aksident ajror në Hungari duke u kthyer në Sllovaki.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ambasadorja e Republikës së Turqisë në Komandën e Forcave Tokësore të FSK-së

Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, më 7 janar 2016, priti në vizitë ambasadoren e Republikës së Turqisë në Kosovë, znj. Kivilcim Kiliç. Fillimisht, gjeneral Hazrolli e falënderoj ambasadoren Kiliç për mbështetjen që Republika e Turqisë po jep për Kosovën dhe në veçanti për FSK-në, përmes shkollimit të kadetëve dhe trajnimeve të ndryshme që po realizohen në Turqi, si dhe atyre që po mundësohen në Kosovë përmes ekipeve mobile të instruktorëve.

Me këtë rast, gjenerali e njoftoi ambasadoren me zhvillimet dhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe së bashku diskutuan për thellimin e mëtejmë të këtij bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe arsimimit, stërvitjes dhe trajnimeve të ndryshme.

Ambasadorja e Turqisë znj. Kivilcim Kiliç falënderoi gjeneral Hazrollin për pritjen, duke i shprehur gatishmërinë e vendit të saj për thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

Në takim morën pjesë edhe rreshter majori i Komandës së Forcave Tokësore, Fetah Zejnullahu, atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovë, nënkoloneli Necdet Ozdemir, si dhe koloneli Omer Turgut.



Zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, vizitoi Forcat e Armatosura të Gjermanisë

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Gjermanisë (FARGJ), nga data 18-22 janar 2016, me ftesë të drejtorit të NLAT-it, gjeneral brigade Stefan Fix, zëvendëskomandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Irfete Spahiu qëndroi për një vizitë zyrtare në Gjermani. Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte njohja nga afër me kurrikulat dhe programet që ofrojnë shkollat ushtarake gjermane, kushtet dhe kriteret e nevojshme për vijimin në këto shkolla, si dhe mënyrat e përgatitjes dhe ekzekutimit të tyre nga Forcat e Armatosura të Republikës së Gjermanisë. Gjatë qëndrimit pesëditor në Gjermani kolonel Spahiu zhvilloi takime pune me komandantin e Shkollës së Oficerëve të FARGJ-s në Dresden, gjeneral brigade Gante, zëvendëskomandantin e Shkollës së Nënoficerëve të FARGJ-s në Delietzch, nënkolonel Farber, zëvendësdrejtorin e Qendrës për Doktrina Taktike,



nënkolonel Pfützenreuter dhe zëvendëskomandantin e Shkollës së Trajnimit Bazik të FARGJ-s në Frankeberg, kolonel Graff. Zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Saphiu, gjatë takimeve të saj të punës, përmes prezantimeve të ndryshme, u njoftua me historinë, rolin, kurrikulat, programet, përgatitjet dhe zbatimin e këtyre programeve dhe kurseve që ofrojnë këto shkolla. Gjithashtu, në secilën nga këto takime u potencua nevoja e vazhdimit të bashkëpunimit dypalësh dhe u bisedua për mënyrat dhe mundësitë e rishikimit të kurrikulave që ofrohen në kurset e KDS-së, si dhe mundësitë eventuale të ristrukturimit të kurseve përkatëse me krerët e së cilave u zhvilluan takimet. Për më tepër, pala gjermane ofroi bashkëpunim të plotë dhe përkrahje të vazhdueshme drejt rishikimit dhe ristrukturimit të programeve të kurseve të ndryshme që zhvillohen në KDS. Po ashtu, ata shprehën gatishmërinë e plotë për përkrahje me ekspertë të fushave të ndryshme, dhe njëherësh potencuan edhe nevojën e shkëmbimeve eventuale të përkohshme në mes të oficerëve dhe nënoficerëve të njësive përkatëse. Vlen të theksohet oferta për dërgimin e oficerëve dhe nënoficerëve të KDS-së si vëzhgues nëpër qendrat dhe shkollat përkatëse të FARGJ-s, gjatë ekzekutimit të trajnimeve dhe kurseve të ndryshme në të ardhmen. Kolonel Irfete Spahiu gjatë vizitës në Gjermani u shoqërua nga drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Stefan Fix, kapiteni Fatlum Demiri dhe rreshter majori Xhevdet Mataj.

Drejtusit e FSK-së homazhe në Memorialin e Reçakut

Me rastin e 17-vjetorit të Masakrës së Reçakut, të kryer nga forcat ushtarake okupuese serbe ndaj civilëve shqiptarë, për vizitë ishte një delegacion i Ministrisë së FSK-së dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) i kryesuar nga ministri Haki Demolli e ku merrnin pjesë zëvendësministrat: Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Bashkim Jashari, Nazmi Brahimaj, Gëzim Hazrolli, zyrtarë dhe oficerë tjerë të lartë të FSK-së. Me këtë rast, ministri Demolli dhe gjeneral Rama në Memorialin e Reçakut në shenjë nderimi për të rënët vendosen lule të freskëta. Ministri Demolli vizitoi edhe varrezat e martirëve, ku takoi edhe familjarët e të rënëve të Reçakut, të cilët i ngushëllojë duke shprehur njëkohësisht krenarinë për ta. "Gjaku i martirëve të Reçakut së bashku me gjakun e gjithë dëshmorëve të rënë u bë themel i Lirisë dhe Shtetit të Pavarur të Kosovës".



FORCA JONË

Intervistë me humanisten amerikane znj. Kathryn Bundy

Mikja Amerikane ndihmonë oficerët e FSK-së

Zonja Kathryn Bundy është një humaniste e madhe amerikane. Ajo ka ndihmuar oficerët e FSK-së nga Kosova dhe nga Shqipëria të cilët u shkolluan në Akademinë ushtarake në "Fort Bennig" të Gjeorgjisë. Ka vizituar Kosovën dhe oficerët e FSK-së tri herë. Dhe gjatë vizitës së fundit me gjithë dëshirë pranoi të intervistohet për gazetën e FSK-së "Forca Jonë".

Zonja Kathryn Bundy është nënë e dy vajzave dhe gjyshe e një nipi, bashkëshorte krenare e një ushtaraku të SHBA-ve. Në Atlanta të Gjeorgjias ka kryer shkollën e mesme dhe studimet në fushën e mjekësisë. Gjatë shërbimit në Gjermani punoi në një Klinik Ushtarake Stomatologjike, kurse në SHBA në bazën Fort Benning. Deri më 2013 ka punuar në Kompaninë RC Cola dhe në Programin e Familjeve Sponzorizuese Nikoqire.

Gazeta "Forca Jonë": *Zonja Kathryn Bundy, ju keni një lidhje shpirtërore me Kosovën?*

Zonja Kathryn Bundy: Lidhja ime shpirtërore ishte një rast shumë interesant. Kur punoja në kompaninë RC Cola në Columbus të Gjeorgjias, isha duke punuar për një produkt që do të vinte në Kosovë dhe në të njëjtën kohë erdhi edhe një oficer nga Kosova për të përfunduar Kursin e Karrierës për Kapiten, pranë Qendrës së Ekselencës për Manovër në Bazën e Ushtrisë në Fort Benning të Gjeorgjias. Oficeri i ri ishte kapiten AvniKiqina. U impresionova nga karakteri i tij prej oficeri, respektin e tij për Amerikën dhe dashurinë për Atdheun e tij. Si bashkëshorte e një ish ushtaraku i kuptoj njerëzit si Kapiten Kiçina, i cili shërbeu në UÇK gjatë luftës të vitit 1998 dhe 1999. Kujtimet e luftës nuk largohen asnjëherë nga zemra. Në fakt këto kujtime e prekën shpirtin e secilit. Si nënë dhe si bashkëshorte unë ndaj të njëjtat emocione me të cilët përjetuan luftën dhe konfliktin.

Gazeta "Forca Jonë": *Zonja Kathryn Bundy, si ishte Kosova për ju gjatë vizitës së parë?*

Zonja Kathryn Bundy: Mund ta shihja kudo dëmin që i ishte bërë Kosovës; ndërtesave, shtëpive, popullatës etj. Mund të shihja procesin e rilindjes së Kosovës. E ndieja vetën krenare që shteti im kishte ndihmuar dhe shpëtuar popullin shqiptar dhe Kosovën në përgjithësi.

Gazeta "Forca Jonë": *Ju vazhdoni të solidarizoheni edhe me familjarët e kadetëve të FSK-së?*

Zonja Kathryn Bundy: Po, vizita ime e fundit në Kosovë, ishte në shtator të 2015-s. Kjo ishte vizita ime e tretë. Unë vazhdoj ta vizitoj Kosovën për arsye se kam takuar shumtë oficerë të FSK-së që vijnë nga Kosova në Fort Bennig për të studiuar. Kështu që, unë vazhdoj të jem sponsorja e tyre "mama amerikane" dhe kështu bëhemi miq përgjithmonë. Më duhej t'i vizitoja dhe të njihesha me familjet e tyre, të cilat më pritën jashtëzakonisht ngrohtë. Kurrë nuk e kam ndier vetën më të lumtur se sa kur u gjenda në mesin e familjeve të oficerëve të FSK-së në Kosovë. Isha e magjepsur me pritjen e shqiptarëve dhe me dashurinë dhe respektin që shprehin ndaj mysafirëve. Të gjithë miqve të mi në Amerikë u kam treguar për mikpritjen shqiptare dhe për dashurinë që kanë për Amerikën dhe popullin amerikanë.



Gazeta "Forca Jonë": *Gjatë vizitës suaj të fundit në Kosovë u pritet edhe nga stafi i lartë i FSK-së?*

Zonja KathrynBundy: Po, gjatë vizitës sime të fundit në Kosovë , nga oficerët e FSK-së që kishin studiuar në Amerikë, mu bë një surprizë dhe nderë, të cilin kurrë s'do ta harrojë. Me të vërtetë e çmoi shumë atë vizitë në Ministrinë e FSK-së dhe kazermën "Adem Jashari". Aty u prita nga oficerët më të lartë të FSK-së, të cilët treguan respekt të madh dhe më nderuan me mirënjohje. Gjithashtu gjatë vizitës në FSK unë takova një kolonel nga SHBA-ja që punon në Ministrinë e FSK-së. Aty ndodhi një surprizë e mirë, pasi ai ishte nga i njëjti vend ku nëna ime ishte lindur. Bota gjithnjë bëhet më e vogël sa më shumë njerëz që takon.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janë përshtypjet tuja për qytetarët e Kosovës?*

Zonja Kathryn Bundy: Kosova ka diçka të veçantë që të bën për vete. Secilin qytetarë që kam takuar në Kosovë ishte shumë mikpritës dhe i shoqërueshëm. Kjo është një pasuri e madhe për popullin shqiptar. Në Kosovë kam shumë miq që më ndihmojë. Edhe pse nuk e flas gjuhën shqipe, nëpërmjet shprehjeve dhe gjesteve të tyre e kuptoj shpirtin e tyre për ta nderuar dhe respektuar mikun. Familjet shqiptare dallohen edhe për ushqimin shumë të shijshëm. Gjithmonë ndihem e mirëpritur në Kosovë. Për këtë i falënderoj të gjitha familjet shqiptare.

Gazeta "Forca Jonë": *Zonja Kathryn Bundy, për shqiptarët ju jeni një humaniste e madhe dhe e respektuar.*

Zonja Kathryn Bundy: Ju falemінderit për mirënjohjen! Siç thash unë jam një familje sponzorizuese nikoqire dhe e marrë me shumë përgjegjësi dhe nderë këtë detyrë. Oficerët të cilët vijnë për të kryer trajnimet i konsideroj si mysafirë të Amerikës dhe më shumë kënaqësi u tregoj atyre respektin që kemi ne për shërbimin që bëjnë. Jeta ushtarake është shumë e vështirë për familjet. Kolektivisht ne sakrifikojmë shumë dhe duhet të bashkohemi për respektim te njëri- tjetri përmes mbështetjes morale, ngaqë ata bëjnë shumë përpjekje për paqe. Jam e nderuar që kam arritur t'i ndihmoj oficerët nga Kosova që po studiojnë në Amerikë. Këtë me shumë dëshirë do ta bëj edhe në të ardhmen.



Gazeta "Forca Jonë": *Cila është lidhja me humanisten amerikane Rose Wilder Lane, e cila i ndihmoi shqiptarët gjatë shekullit të fundit, në momentet e tyre më të vështira në histori?*

Zonja Kathryn Bundy: Kam dëgjuar për humanisten amerikane Rose WilderLane dhe më ka lënë përshtypje interesimi dhe puna e saj për t'i ndihmuar shqiptarët në kohët më të vështira. Ndërsa unë, si bashkëshorte e një ushtaraku, kam arritur t'i kuptoj më së miri sakrificat që ushtarakët tanë bëjnë për ta ruajtur paqen. Dashuria ime për njerëzit nga Kosova që shërbejnë në uniformë është si po të isha një "nënë" e tyre. Unë i kam dy vajza. Por, sikur të kisha një djalë i cili do shërbente diku në ndonjë vend tjetër, do të doja të rrija me mendimin se njerëzit tregojnë dashuri dhe respekt për të. Në Amerikë ne krenohemi shumë me ushtrinë tonë. Ne mundohemi t'i nderojmë ata për çdo gjë që bëjnë dhe sa më shpesh që është e mundur. Ne besojmë se "s'ka njeri më të madh se ai i cili është i gatshëm ta jap jetën për jetën e të tjerëve"!

Gazeta "Forca Jonë": *Zonjë e nderuar, në ShBA ju po i ndihmoni oficerët e FSK-së ?*

Zonja Kathryn Bundy: Asistimi që u bëj kadetëve të FSK-së është një nder për mua. Unë do të doja të jem "nëna" e tyre ndërkombëtare dhe t'ua jap ndjesinë e shtëpisë larg nga shtëpitë e tyre. Amerikanët janë shumë patriotë. Ne i nderojmë ushtarakët tanë dhe i mbajmë lart në konsideratën tonë për atë që bëjnë ata. Liria jonë bazohet në shërbimin dhe sakrificën e tyre. Jam me të vërtetë shumë krenare për dy oficerët nga Kosova, të cilët arritën rezultatet më të larta në gjeneratat e tyre. Ata përfunduan "Kursin Bazik për Oficerë të Këmbësorisë në Fort Benning. Ky kurs është njëri nga më të vështirët dhe sfiduesit për oficerët e këmbësorisë në Fort Benning. Ata testohen për aftësitë e tyre akademike ushtarake si dhe për shkathtësitë dhe qëndrueshmërinë fizike. Ata duhet të trajnohen me më të mirët e më të mirëve në Ushtrinë Amerikane dhe kjo nënkupton se anglishtja e tyre duhet të jetë me të vërtet e cilësisë së shkëlqyeshme. Në maj 2014 Kreshnik Zeneli dhe në shtator 2014 Shpëtim Dragobuzhda ishin oficerët më të dalluar ndërkombëtarë për gjeneratat e tyre përkatëse. Të dy këta oficerë kishin diplomuar në Akademinë Ushtarake të Kosovës (QSU). Unë kam asistuar 20 oficerë nga Kosova që nga shtatori i 2011-s dhe do të doja të shoh tek vijnë edhe më shumë për trajnime në Fort Bennig të Gjeorgjisë së SHBA-së. Këto trajnime i ndërtojnë lidhjet e vendeve tona përkatëse.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili do të ishte mesazhi juaj për qytetarët e Kosovës?*

Zonja Kathryn Bundy: Ne duhet të besojmë në Zot, që të na jap forcë dhe guxim për të bërë gjëra të drejta në jetë. Asgjë nuk është e lehtë. Ne duhet të punojmë shumë për t'i përmirësuar kushtet tona. Përfshirja bashkëpunuese është e rëndësishme, duke filluar nga Qeveria e deri te qytetarët. Besoj se "çfarëdo që bën të kthehet", kështu që gjithmonë bëni gjëra të drejta dhe ju them të jeni qytetarë të shkëlqyeshëm për njëri- tjetrin. Në fund, nga zemra uroj të gjithë oficerët e Kosovës, duke ju dëshiruar suksese për vitin 2016. Pres të më plotësohet dëshira edhe në vitin 2016, t'i pres bijtë e mi, (oficerët nga Kosova) në Fort Bennig të Gjeorgjisë në ShBA.

Intervistë me nëntogerin e FSK-së, Ismajl Hoxha

Kadeti i FSK-së më i miri i gjeneratës në Akademinë Sandurst të Anglisë

Nëntoger Ismajl Hoxha në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst në Britaninë e Madhe (dhjetor 2015) shpallet kadeti më i mirë. Shpatën e ka pranuar nga Princi Charles i Anglisë. Është hera e parë që një përfaqësues ushtarak nga Ballkani e merr këtë çmim. Për këtë shfrytëzuam rastin të bëjmë një bisedë për gazetën e FSK-së "Forca Jonë"

Gazeta "Forca Jonë": *Si ju lindi dëshira për t'u bërë kadetë i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së?*
N/Toger HOXHA: Unë qysh si fëmijë e kam pas një lloj simpatie për disiplinën e mirëfilltë ushtarake. Ndërkohë çdo herë jam marrë me aktivitete jashtë edukimit obligues. Si fillorist merresha me karate, ndërsa gjatë shkollimit të mesëm me basketboll. Domethënë, këto ishin dy aktivitete pak më intensive që mbase kanë ndikuar në parapërgatitjen time fizike. Por për dallim nga këto, kujtoj që si i vogël e kam dashur edhe pikturën. Pikturoja si i pavarur, madje e pata ndjekur dhe një kurs për pikturë. Me një fjalë, i kam dhëne vetes lirinë për të provuar çdo gjë ndaj së cilës e kam pas njëlloj atraksioni, liri që e kisha edhe nga familja gjithmonë.
Kur e kam kuptuar që Qendra për Studime Universitare ekziston si institucion brenda FSK-së, ajo dëshira për të qenë një oficer i ardhshëm më është ngjallë. Kjo për faktin se tashmë unë e kisha një vizion më të çartë se kjo dëshirë mund të bëhej realitet, sepse u njoftova se QSU-ja është një qendër e mirëfilltë e studimeve ushtarake, që çdo qytetar i vendit do të donte ta kishte shteti ynë, gjë të cilën tashmë edhe gëzojmë. Prandaj, QSU-ja për mua ka qenë motivi kryesorë për të ndjekur këtë profesion. Në të njëjtën kohë kuptova që programi ishte shumë sfidues në shumë aspekte dhe e dija që mënyra më e mirë për të zhvilluar vetveten ishte duke sfiduar vazhdimisht nivelin tim në të gjitha aspektet. Pa dyshim, rol të madh për arritjen e këtij qëllimi ka luajtur edhe familja ime me një mbështetjen tepër të madhe, veçanërisht vëllai im Majmal Hoxha.



Gazeta "Forca Jonë": *Cilat ishin sfidat nëpër të cilat keni kaluar si kadetë i FSK-së?*
N/Toger HOXHA: Një kadet i QSU-së kalon nëpër sfida të shumta. Sfida e parë dhe që unë konsideroj që është njëra nga më të vështirat është tranzicioni nga jeta civile në jetën ushtarake. Kur merr statusin e një kadeti mënyra e jetesës ndryshon nga ajo paraprake. Disiplina është themeli i formësimit të një karakterit të ri të cilit në një të ardhme të afërt do t'i besohet puna e udhëheqjes së trupave të FSK-së. Mënyra më e mirë për tejkalimin e kësaj sfide është që gjërat e vogla por shumë të rëndësishme të bëhen mirë në mënyrë të vazhdueshme sepse ato kalojnë në shprehi dhe shprehitë në karakter.
Ndër sfidat tjera ishte edhe të qenët larg familjes dhe shoqërisë. Mirëpo, duke pasur mbështetjen e plotë të dy palëve kjo sfidë ka qenë shumë më e lehtë.

Gazeta "Forca Jonë": *Gjatë studimeve në QSU siguristh që keni pasur momente të mira.*
N/Toger HOXHA: Patjetër që kemi pasur edhe shumë momente të mira, që gjithmonë do të mbeten në kujtimet e mia. Natyrisht që një dozë e humorit ka qenë e nevojshme dhe ka pasur një ndikim pozitiv për kalimin e sfidave të cilat na janë vënë përpara. Katër vite e kemi bërë një jetë të përbashkët me shokët e gjeneratës. I kemi ndarë sfidat, por edhe momentet e mira së bashku. Derisa ndër qëllimet kryesore të këtij programi është fryma ekipore për punë ajo gjatë gjithë kohës ka prodhuar edhe momente të mira dhe relaksim për ne. Puna në grup, është e normuar brenda programit të akademisë, dhe si e tillë ajo imponohet nga dita e parë, kur e fillon jetën e një kadeti. Prandaj, momentet më të mira i kemi pasur kur kemi arritur diçka si ekip, dhe kjo është më e bukura e mësimit që nxjerrim nga kjo shkollë, pra ndarja e punëve, përgjegjësive, por edhe arritjeve, sukseseve dhe momenteve të lumtura si një ekip i bashkuar.



Gazeta "Forca Jonë": *Si kadet i FSK-së për 12 muaj keni studiuar në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurs të Anglisë. A mund të thoni diçka më shumë?*
N/Toger HOXHA: Në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Angli, 12 muaj rresht kanë qenë të mbushur me një përvojë jashtëzakonisht të mirë për mua. Jam jashtëzakonisht falënderues që më është dhënë mundësia të mësoj dhe të zhvillohem në aspektin profesional. Në të njëjtën kohë kam qenë i privilegjuar që ta përfaqësoj institucionin e FSK-së në Akademinë Mbretërore të Anglisë, për arsye se në këtë institucion ka pasur edhe shumë kadetë të tjerë ndërkombëtarë të cilët e kanë vijuar Akademinë në të njëjtën kohë me mua. Kjo ka bërë që unë të kem mundësinë që të krijoj marrëdhënie të mira shoqërore me secilin prej tyre dhe në të njëjtën kohë t'i kuptoj ato ndryshimet që ekzistojnë në kulturat e ndryshme ushtarake.

Gazeta "Forca Jonë": *Jeni shpallur kadeti ndërkombëtar më i mirë në Akademinë Mbretërore në Angli, cila ishte sfida?*
N/Toger HOXHA: Në fakt, i gjithë programi në që nga fillimi e deri në fund ka qenë sfidë në vete. Mirëpo, unë them se për mua sfida më e madhe ka qenë që personalisht të marr vendimin që të punoj për marrjen e një çmimi të tillë. Në momentin që e kam marr atë vendim, atëherë me çdo sfidë që jam përballur e kam pasur shumë më të lehtë ta tejkaloj për arsye se e kam ditur qëllimin tim. E dini, aty kishte 180 pjesëmarrës nga mbarë bota, dhe më është dashur të punoj me veten, duke pasur paralelisht një mbështetje të pakursyer nga familja, që pa marrë parasysh vështirësitë tona që i kemi për të ecur përpara si një shtet i ri dhe i vogël me shumë probleme, të ja vë vetes si qëllim që ditën e diplomimit Republika e Kosovës të dalë triumfuese dhe ta rrëmbejë çmimin e parë nga pjesëmarrja ndërkombëtare në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst të Anglisë.

Gazeta "Forca Jonë": *Si i përshkruani momentet e pranimit të shpatës nga princi i Anglisë Charles, dhe si e keni kuptuar mesazhin e tij?*
N/Toger HOXHA: Absolutisht ka qenë një ndjenjë e përmbushjes. Dita më e lumtur e jetës sime deri tani. Mundësia për të përfaqësuar institucionin e sigurisë së shtetit të Kosovës dhe duke dal triumfues përpara Princit Charles të Anglisë ka qenë një moment shumë i veçantë, aq më tepër kur Shteti i Kosovës pati një vëmendje më të lartë. Ndërsa mesazhi dhe mësimi kryesor që kam nxjerrë atë ditë ishte që mundi dhe puna njëvjeçare u shpërblyen në fund.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është niveli i studimeve në Akademinë Mbretërore në Sandhurs?*
N/Toger HOXHA: Po, vetë tradita mbi 100 vjeçare si Akademi fletë për nivelin e studimeve të këtij institucioni ushtarak, me një traditë dhe përvojë ndërkombëtare. Nga kjo akademi kanë dalë shumë udhëheqës luftërash dhe shumë burrështetas të botës.

Gazeta "Forca Jonë": *Përvojën e fituar në Akademinë e Londrës sa do të jeni i gatshëm ta zbatoni në FSK ?*
N/Toger HOXHA: Tash e tutje qëllimi im kryesor është që përvojën që e kam fituar në Akademinë Mbretërore ta zbatoj dhe ta shpërndaj mes kolegëve dhe kolegeve në FSK. Unë besoj në punën ekipore dhe padyshim është mënyra e vetme për sukses. Prandaj shpresoj që të kem mundësinë që së bashku me të gjithë të punojmë për zhvillimin e FSK-së si një forcë profesionale.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janë planet për të ardhmen tuaj?*
N/Toger HOXHA: Në të ardhmen e shoh veten duke shërbyer në ushtrinë e Kosovës. Sa i përket planeve njëvjeçare, me një ekip shumë të dedikuar kemi filluar përgatitjet për përfaqësimin e Kosovës në ngjarjen e njohur si "Cambrian Patrol" në Angli. Është hera e parë që Kosova si shtet merr pjesë në këtë ngjarje dhe do të punojmë sa më shumë që është e mundur që FSK-ja të ketë një përfaqësim të denjë dhe profesional. Kjo ngjarje do të mbahet në tetor të këtij viti.

Gazeta "Forca Jonë": *Ciliështë mesazhi i juaj për ushtarët, kadetët dhe nënoficerët e FSK-së?*
N/Toger HOXHA: Unë them se bartja e uniformës është një privilegj i jashtëzakonshëm për të gjithë ne, veçanërisht duke pasur parasysh historinë tonë si komb dhe luftën e fundit. Në këtë kontekst unë besoj që secili prej nesh individualisht e ka obligim moral që të jap gjithçka nga vetja për zhvillimin e FSK-s si një forcë profesionale e cila gjithmonë është e gatshme për të pranuar përgjegjësi të reja! Vetëm me punë të përbashkët në grup, me nderë, sinqeritet dhe vullnet mundë ta avancojmë FSK-në edhe më shpejtë në rrugën e saj të pakthyeshme të të qenët një ushtri në mbrojte të vlerave universale, qe edhe i synojmë si vend, duke ndjekur kështu qëllimin e shumë brezave para nesh. Ne jemi sot këtu sepse ata ishin dje!

Planifikim i përbashkët me IOWA-n për zhvillimin dhe avancimin e trupës së nënoficerëve të FSK-së

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, nga data 24-29 janar 2016, është mbajtur seminari me ekspertë nga IOWA (ShBA) dedikuar planifikimit të përbashkët për zhvillimin dhe avancimin e trupës së nënoficerëve. Të pranishëm në ceremoninë përmbyllëse ishin: komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant RrahmanRama, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, atasheu amerikan, koloneli Chad Batts, si dhe oficerë e nënoficerë të FSK-së, të Gardës Kombëtare të IOWA-s, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, rreshter majori Rachel Fails, CMSGT Timothy E Cochran, CSM David Enright dhe CMM Robert Warrington. Para të pranishmëve, rreshter majori i parë i komandantit të FSK-së, Genc Metaj së bashku me rreshter majorin nga IOWA Rachel Fails prezantuan planin e përbashkët të punuar gjatë këtyre ditëve për planifikimet 1-3 vjeçare, 3-5 vjeçare dhe më shumë se 5 vjeçare, duke dhënë kështu një bazë të mirë për zhvillimin dhe profesionalizimin e trupës së nënoficerëve në periudhat kohore, sipas këtyre pesë prioriteteve: Zhvillimi profesional dedikuar zhvillimit të nënoficerëve, Zhvillimi i databazës së trajnimeve për nënoficerë, Riorganizimi i strukturës, Zhvillimi individual i detyrave të përbashkëta dhe Ngritja e autoritetit të nënoficerëve të rinj në njësi. Me këtë rast, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama pasi falënderoi instruktorët nga IOWA për kontributin e tyre në ngritjen profesionale të FSK-së, tha: "Vetëm




gjatë vitit 2015 FSK-ja ka pasur mbi 40 aktivitete të përbashkëta me instruktorët e Gardës Kombëtare dhe Ushtrinë Amerikane. Falë këtij bashkëpunimi dhe partneriteti që kemi me këtë vend mik, kemi arritur zhvillime të rëndësishme në këtë sektor. Qëllimi ynë kryesor ka qenë zhvillimi i trupës së nënoficerëve, sepse pa zhvillimin e kësaj trupe nuk mund të ketë ushtri të suksesshme. Prandaj, ju jeni përgjegjës për të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar dhe do të zhvillohen për sa i përket kësaj fushe, dhe do të keni mbështetjen time të pakursyer ashtu siç e keni pas deri më sot. Në fjalën e tij koloneli amerikan Batts theksoi: "Në planin e prezantuar nga nënoficerët pashë pjesë të cilat janë të rëndësishme sot për FSK-në dhe të cilat do të lidhen edhe në të ardhmen pas transformimit, dhe kjo më gëzon që keni bërë planifikime edhe për të ardhmen, siç është identifikimi i personelit për të zhvilluar dhe avancuar ngritjen e nivelit të gjuhës angleze". Për këto zhvillime të arritura në të gjitha fushat, sidomos në fushën e zhvillimit të nënoficerëve, ju jemi mirënjohës miqve tanë për mbështetjen e tyre të vazhdueshme, andaj neve na mbetet vetëm të punojmë dhe të ecim përpara. Në fund, gjeneral Rama ndau mirënjohje për angazhimin e instruktorëve nga IOWA duke i falënderuar edhe për bashkëpunimin.

FSK-ja mban ligjërata vetëdijesimi për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht Kompania e Deminimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), më 15 janar 2015, filloi mbajtjen e ligjëratave për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i minave dhe mjeteve tjera të ndryshme eksplozive të pashpërthyera në shkollën fillore "Teuta" në Grashticë dhe "Ganimete Tërbeshi" në Llukarë të Prishtinës. Projekti po realizohet në bazë të planit të veprimit të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në MFSK në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Bazuar në këtë plan, Njësia e Kompanisë së Deminimit e FSK-së e trajnuar për edukim, që nga 15 janari i këtij viti, ka filluar fushatën për vetëdijesimin e nxënësve në shkollat fillore të cilat gjenden në afërsi të zonave të prekura nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera, na thotë AhmetSallova, shef i Qendrës Koordinuese për Deminim në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i cili shton: "Kjo fushatë bëhet me qëllim të parandalimit të incidenteve me mina apo mjete tjera të pashpërthyera, pasi që këto mjete eksplozive të luftës ende vazhdojnë të lëndojnë banorët e Kosovës, ku nga paslufta në Kosovë (viti 1999) kanë humbur jetën 116 qytetarë, ndërsa mbi 459 veta i kanë humbur gjymtyrët e tyre dhe kanë mbetur tërë jetën me pasoja. "Qëllimi ynë është t'i ndërgjegjësojmë nxënësit dhe qytetarët e Kosovës se si duhet të veprojnë në rast se hasin në mjete të tilla të rrezikshme, duke ditur se qytetarët, e posaçërisht fëmijët, janë kureshtar t'i prekin objektet e





dyshimta pa e kuptuar rrezikun që mund t'iu kanoset nga to", tha në fund zoti Sallova. Ndërsa, komandanti i Kompanisë së Deminimit, kapiten Sejdi Krasniqi thotë se ligjëratat për edukimin dhe vetëdijesimin e nxënësve për rrezikun nga mjetet e pashpërthyera do të mbahen në 11 komuna, si: Prishtinë, Podujevë, Drenas, Shtime, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Prizren, Hani i Elezit, Kaçanik dhe Malishevë, kryesisht në ato komuna ku njësitet e EOD-së kanë pasur raste më të shpeshta intervenimi, bazuar edhe në telefonatat e qytetarëve. Këto ligjëratat janë paraparë të mbahen në 31 shkolla dhe do të marrin pjesë mbi 1500 nxënës. Kapiten Krasniqi i vlerësoi lart njohuritë e fëmijëve lidhur me rrezikun nga minat dhe mjetet e pashpërthyera. Ai tha se tashmë fëmijët janë në gjendje t'i njohin ngjyrat, format dhe procedurat se çka duhet të ndërmarrin ata pasi të shohin një mjetë të rrezikshëm. "Shumica e nxënësve falë këtyre ligjëratave janë aftësuar jashtëzakonisht shumë lidhur me mjetet e pashpërthyera, madje ka pas raste kur ata vetë na kanë informuar se kanë hasur në këto mjete".

Certifikohen pjesëtarët e FSK-së në trajnimin "Gatishmëria mjekësore për shëndetin gjatë zbarkimit"

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilët ndoqën trajnimin treditor "Sanitaria dhe Higjiena Fushore". Gjatë këtij trajnimi u trajtuan tema të ndryshme; si gatishmëria mjekësore, zbarkimi i trupave në terren, kushtet dhe kujdesi që kërkohet pas zbarkimit të trupave etj. Trajnim u realizua nga instruktorët e mjekësisë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës të Forcave Ajrore, CPT Brandy Sande, SGT Jeffrey Segal, CPT Chris Costello dhe SGT Aaron Delperdang. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: kolonel Bashkim Shillova shef i Operativës në Komandën e Forcave Tokësore, kolonel Xhevdet Tahiri- drejtor i Departamentit të Mjekësisë në MFSK dhe majori Roux nga ambasada e SHBA-ve në Prishtinë. Kolonel Xhevdet Tahiri falënderoi instruktorët amerikanë për kontributin dhe ndihmën e tyre që janë duke dhënë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e në veçanti për ngritjen e kapaciteteve të Kompanisë së Mjekësisë sipas standardeve të Ushtrisë



amerikane. Ndërsa kolonel Shillova u shpreh mjaft i kënaqur me të arriturat e përgjithshme të pjesëtarëve të FSK-së gjatë këtij trajnimi, si dhe kërkoi nga ta që njohuritë e fituara t`i zbatojnë gjatë ushtrimeve dhe trajnimeve të cilat do të realizohen në terren. "Është privilegj për ne që të mësojmë nga eksperienca e partnerëve tanë, dhe njohuritë e fituara gjatë këtij trajnimi do të na shërbejnë të ecim rrugës së tyre, si një forcë profesionale dhe e përgatitur mirë në shërbim të vendit dhe të popullit tonë" -tha kolonel Shillova.

Në kazermën ,,Adem Jashari " të FSK-së u përurua Salla e sporteve





Në ambientet e kazermës ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së në Prishtinë, u mbajt ceremonia e përurimit të Sallës së sporteve për pjesëtarët e FSK-së. Në ceremoni të pranishëm ishin: Gjeneral brigade Zymer Halimi- drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore- gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i Shtabit të Forcave Tokësore- kolonel Naim Haziri, këshilltari i komandantit të FSK-së- kolonel David Jones dhe oficerë e nënoficerë të FSK-së. Forca e Sigurisë së Kosovës për çdo ditë është duke krijuar mundësi dhe hapësira të reja për zhvillimin e pjesëtarëve të saj si në aspektin intelektual ashtu edhe atë fizik. Kjo sallë sportive do t`u krijojë pjesëtarëve të FSK-së shumë mundësi për realizimin e aktiviteteve të ndryshme fizike. Këshilltari i komandantit të FSK-së, koloneli David Jones, i cili së shpejti do të përfundojë misionin e tij katërvjeçar në Kosovë, gjatë kësaj ceremonie përurimi ndër të tjera u shpreh se ndjehet mjaft i impresionuar me kushtet e krijuara gjatë periudhës së shërbimit të tij në FSK". Koloneli anglez David Jones dha një kontribut të çmuar në zhvillimin e sportit në FSK në përgjithësi, e në veçanti në zhvillimin e futbollit. Ai flet me respekt për ekipin e futbollit të FSK-së, duke kujtuar edhe disa lojëra të këtij ekipi, siç është loja e zhvilluar në me FSK-së dhe Ushtrisë së Malit të Zi. FSK-ja në planin e saj zhvillimor të infrastrukturës është duke ndërtuar salla të tilla në të gjitha kazermat.

Kompania e Mjekësisë mbajti trajnimin - Sanitaria dhe Higjiena Fushore



Në kazermën "Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilët ndoqën trajnimin një javor " Sanitaria dhe Higjiena Fushore ", nga një ekip ekspertësh të fushës së mjekësisë nga Spitali i Ushtrisë Amerikanë të kampit "Bondsteel". Me këtë rast, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli falënderoi ekipin e instruktorëve që ndihmuan në realizimin e këtij trajnimi, dhe njëherësh u shpreh mjaft i kënaqur me të arriturat e përgjithshme të pjesëtarëve të FSK-së. "Duke u bazuar në trajnime të shumta që kanë ndjekur pjesëtarët e FSK-së, mund të themi se ata kanë arritur rezultate mjaft të larta, por ngritja profesionale asnjëherë nuk ka të ndalur. Edhe ky trajnim ka një rëndësi të veçantë për ne, ku pjesëtarët tanë patën mundësi të mësojnë nga eksperienca e juaj e madhe në këtë fushë, për sa i përket ngritjes së nivelit të higjienës dhe kujdesit shëndetësor gjatë ushtrimeve fushore". I kënaqur nga mbarëvajtja e këtij trajnimi u shpreh edhe komandanti i Task-Forcës Mjekësore të Bondsteellit, kolonel Valinotti, i cili përgëzoi pjesëtarët të cilët morën pjesë në këtë trajnim. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin drejtori i Departamentit të Mjekësisë në MFSK, kolonel Xhevdet Tahiri, zëvendëskomandanti i Kompanisë së Mjekësisë, major Genc Shala, rreshter majori i KFT-së Fetah Zejnullahu, këshilltari i NLAT-it, kolonel Matti si dhe këshilltari i komandantit të KFOR-it, kolonel Schwederski -Nenke. Në fund të ceremonisë, për realizimin me sukses të trajnimit, gjenerali Gëzim Hazrolli ndau mirënjohje dhe certifikata për ekipin e instruktorëve amerikanë dhe për pjesëtarët e FSK-së.

FSK-ja zhbllokoi nga bora banorët e fshatit Gllboqicë të zonës kufitare të Dragashit

Pas reshjeve të mëdha të borës në Kosovë, gjatë muajit janar, shumë banor të fshatrave të Gllboqicës komuna e Dragashit kishin mbetur të bllokuar në shtëpitë e tyre. Banorëve të këtyre zonave në ndihmë u erdhi FSK-ja. Ekipi i Togut të Parë të Batalionit të xhenios intervenoi me tri automjete dhe një ngarkues. Ata hapën rrugën në fshatin Borë afër tre kilometra, dhe në fshatin Krushevë, drejt zonën kufitare që lidh fshatin Shishtavec në gjatësi prej 4 kilometra. Intervenimi i Batalionit të xhenios ka përfunduar me sukses dhe pjesëtarët e saj, e kanë kryer punën me përgjegjësi dhe profesionalizëm të lartë. Ata , me një punë ekipore kanë bënë pastrimin e rrugëve nga bora në gjatësi prej 7 kilometrave, me qëllim për t'ia mundësuar banorëve të dy anëve të kufirit një qarkullim të lirë, pas bllokimit nga bora. "Edhe përkundër kushteve të vështira atmosferike që mbretëronin në orët e mbrëmjes, ekipi i FSK-së falë angazhimit maksimal dhe profesionalizimit ka arrit që në kohën më të shkurtër ta realizojë këtë projekt, që përfitues ishin banorët e fshatrave në zonën kufitare Kosovë-Shqipëri, të cilët kishin mbetur të bllokuar nga bora" na thotë Toger Hajri Kurtaj. Edhe banorët e këtyre fshatrave falënderojnë pjesëtarët e FSK-së, për hapjen e rrugës dhe zhbllokimin e tyre nga bora.



Intervistë me Afrim Nebihun përgjegjës për sportet në Forcën e Sigurisë së Kosovës

FSK-ja rëndësi të veçantë po i kushton infrastrukturës sportive

Në shenjëtari FSK-ja në Kosovë është pa konkurrencë. Tri herë kampion i Kosovës në futboll të vogël dhe një herë fitues i Kupës së Kosovës. Rëndësi të veçantë po i kushtohet përmirësimit të infrastrukturës sportive.

Gazeta "Forca Jonë": *Në kuadër të FSK-së cilat aktivitete sportive organizohen sot?*
Afrim Nebihu: Në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) zhvillohen të gjitha llojet e sporteve, duke filluar nga fitnesi fizik e deri te sportet tjera, si: futboll i madh dhe i vogël, volejboll, pingpong, basketboll, shenjëtari, shah, atletikë, si dhe sportet luftarake (karate).

Në kuadër të FSK-së për çdo vit organizojmë garat sportive, por marrim pjesë edhe në kuadër të garave që mbahen në Republikën e Kosovës, si në futboll të vogël etj. Ndërsa, për nder të Ditës së Forcës (më 27 Nëntor), për dy muaj rresht mbahen garat sportive, ku marrin pjesë mbi 500 pjesëtarë të FSK-së, përfshirë të gjitha njësitet e saj. Zakonisht garat mbahen në katër disiplina: Futboll, Atletikë, Shenjëtari dhe Shah, në të gjitha kazermat e FSK-së. Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim po i kushtojmë përmirësimit të infrastrukturës dhe fushave sportive. Në shumë kazerma kemi salla të sporteve, kurse në muajin janar 2016 edhe në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë përuruam kompleksin sportiv, një sallë moderne, që mund të zhvillohen të gjitha llojet e sporteve.

Gazeta "Forca Jonë": *Si udhëheqës sa jeni i kënaqur me të arriturat tuaja?.*
Afrim Nebihu: Në përgjithësi, falë edhe angazhimit dhe përkrahjes nga stafi udhëheqës i FSK-së, jemi të kënaqur me avancimin e sporteve, mirëpo gjithmonë ka vend për përmirësime dhe zhvillime të reja. Unë personalisht jam i kënaqur me të arriturat në futboll gjatë dy viteve të fundit. Kemi ekipin në futboll të madh dhe të vogël. Po ashtu, gjatë vitit 2015 është risi formimi i ekipin të futbollit të femrave. Në këtë drejtim kontribut të madh ka nëntoger Mimoza Budeci.



Gazeta "Forca Jonë": *Keni luajtur disa ndeshje kombëtare dhe ndërkombëtare në futboll të madh, ku është sot futbolli i FSK-së sipas jush?*
Afrim Nebihu: Pas formimit të klubit në futboll të madh, kemi zhvilluar trajnime intensive dhe shumë ndeshje me klube të ndryshme që garojnë në ligën e parë të Kosovës. Futbollistët e FSK-së, edhe pse pa përvojë, kanë treguar se dinë të luajnë dhe të organizojnë gara edhe të këtij niveli. Në këtë drejtim na ka ndihmuar këshilltari i komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nënkoloneli DavisJones, të cilin e falënderojmë nga zemra. Në klubin e FSK-së janë të angazhuar pjesëtarët (lojtarët) më të mirë, të seleksionuar nga të gjitha njësitet e FSK-së. Kemi zhvilluar dy ndeshje me Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe me disa klube të ligës së parë të Kosovës. Në bazë të asaj që kemi treguar në fushë me futbollistët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, edhe pse pa përvojë, jemi përafërsisht të të njëjtit nivel. Gjithashtu kemi zhvilluar edhe dy ndeshje ndërkombëtare me Malin e Zi (futboll të vogël) dhe kemi treguar se jemi në një rang me vendet fqinje.

Gazeta "Forca Jonë": *FSK-ja kohëve të fundit po garon në nivel të Kosovës në "Fut-sall" futboll të vogël. A mund të na thoni diçka më shumë?*
Afrim Nebihu: Jemi pjesëmarrës në Ligën Institucionale në kuadër të Federatës së Sporteve të Punëtorëve të Kosovës në futboll të vogël, ku edhe kemi arritur rezultate jashtëzakonisht të mira duke u bërë kampion tri herë radhazi dhe fitues të kupës së të njëjtës ligë. Por, qëllimi ynë është që në të ardhmen të bëjmë gara, me ekipin e FSK-së në futboll të madh, në kuadër të Ligave të Kosovës. Mendoj se ky ekip posedon potencial për të qenë një ekip i mirë i cili do të pasuronte futbollin e Kosovës.

Gazeta "Forca Jonë": *Çfarë ju bën të ndiheni krenarë?*
Afrim Nebihu: Krenaria ma e madhe për mua është se jemi duke e avancuar Ushtrinë e Kosovës e në kuadër të kësaj edhe sportin. Besoj se në një të ardhme të afërt FSK-ja do të krijojë ekipe dhe sportistë të dalluar në të gjitha profilet. Dua të theksoj se ekipi i shenjëtarisë i FSK-së është pa konkurrencë në nivel të Kosovës.

Gazeta "Forca Jonë": *Nëse nuk është fshehtësi, si i arrini këto rezultate?*
Afrim Nebihu: Falë punës së palodhshme dhe këmbëngulëse, po ashtu edhe disiplina në nivel të lartë janë faktorët kryesorë të suksesit.
Gazeta "Forca Jonë": *Cilat janë planet për zhvillimin e futbollit dhe sporteve tjera në kuadër të FSK-së?*
Afrim Nebihu: Ne kemi punuar një plan të përgjithshëm dhe afatgjatë për zhvillimin dhe avancimin e të gjitha sporteve në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në radhë të parë jemi duke krijuar kushtet për zhvillimin dhe avancimin e tyre. Në çdo kazermë të FSK-së kemi ndërtuar salla të sporteve si dhe fusha për zhvillimin e tyre. Deri më tani përparësi i kemi kushtuar futbollit të madh dhe atij të vogël, ku edhe kemi arritur t'i konsolidojmë ekipet me të cilët gjatë zhvillimit të shumë ndeshjeve ndërkombëtare kemi treguar se dimë të luajmë dhe kemi perspektivë. Por, të arriturat më të mëdha i kemi në futboll të vogël, ku siç e thashë edhe më lartë, jemi më të mirët në Kosovë. Po punojmë që në të ardhmen të marrim pjesë në garat e Kosovës në futboll të madh dhe të vogël si dhe në garat e ushtrive të botës, si në futboll, shenjëtari etj.





FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 44 • Mars 2016 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë takoi Ministrin dhe Komandantin e FSK-së

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën në takim zyrtar në Qeveri, komandantin e Komandës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges. Fillimisht ministri Demolli e falënderoi gjeneralin Hodges për angazhimin e ushtarakëve amerikanë në kuadër të KFOR-it, si dhe për tërë përkushtimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Kosovën, e në veçanti Ushtrinë amerikane si dhe Gardën Kombëtare të Aiovës me të cilën Forca e Sigurisë bashkëpunon shumë ngushtë në kuadër të programit shtetëror Kosova-Aiova. Më tej ministri Demolli e njoftoi komandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropë me zhvillimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë, procesin dhe masat që janë marrë në drejtim të përgatitjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë dhe gjithashtu edhe për



përkushtimin për transparencë të plotë gjatë procesit. Nga ana e tij komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral Rrahman Rama, gjatë takimit e njoftoi gjeneralin Hodges me misionin, strukturën, kapacitetet, gatishmërinë operacionale të FSK-së, si dhe mbi suksesin e FSK-së në drejtim të ndërtimit të raporteve të bashkëpunimit me shumë prej ushtrive të vendeve të NATO-s, e gjithashtu mbi aktivitetet dhe operacionet e realizuara sipas misionit në të mirë të vendit dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Gjeneral Rama shtoi po ashtu se FSK-ja është e gatshme të vazhdojë bashkëpunimin me të gjithë partnerët drejt zhvillimit të një force profesionale dhe shumetnike që është në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe kontribuues në sigurinë në regjion dhe më gjerë. Një prezantim mbi rrjedhën e procesit të planifikimit dhe transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura e paraqiti shefi i Zyrës për Transformim, nënkolonel Jeton Dreshaj, i cili e njoftoi gjeneralin Hodges dhe delegacionin amerikan hollësisht mbi planin e transformimin. Nga ana e tij komandanti i Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges u shpreh i kënaqur me prezantimin lidhur me transformimin FSK-së. ,Jam i impresionuar më kualitetin e planit Planet e mira janë optimiste për të ardhmen dhe vendimet e juaja. Një plan i brendshëm, vendimi për transformim dhe kur udhëheqësit politikë bëjnë atë që duhet në lidhje me legjislacionin, atëherë FSK do të jenë gati që ta bëjnë pjesën e tyre dhe me të vërtetë mezi po presim që kjo të ndodhë" Në takimin me ministrin Demolli dhe komandantin Rama, ishin të pranishëm edhe zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi Departamentit për bashkëpunim dhe siguri, kolonel Ilir Qeriqi, si dhe shefi i kabinetit të ministrit Latif Leku dhe asistenti ushtarak i komandantit të FSK, major Berat Shala.

Ministri Demolli u prit me nderime ushtarake në Turqi

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), z. Haki Demolli më 3 shkurt 2016, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, z. Ismet Yilmaz, qëndroi për një vizitë zyrtare në Republikën e Turqisë. Ministri Demolli u prit me nderime ushtarake nga ministri i Mbrojtjes z. Ismet Yilmaz dhe Garda kombëtare. Ministri i Mbrojtjes së Turqisë, z. Yilmaz fillimisht falënderoi ministrin Demolli për vizitën, dhe më pas të dy ministrat bisedua për bashkëpunimin e deritashëm ndërmjet dy ministrive si dhe për intensifikimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen në të gjitha fushat me interes të përbashkët, si në fushën e edukimit dhe arsimimit, stërvitjes, trajnimeve etj. Ministri i FSK-së, z. Demolli pasi falënderoi ministrin e Turqisë për ndihmën që shteti i tij në vazhdimësi po jep për Kosovën e në veçanti për FSK-në, kërkoi nga ai që të vazhdojë përkrahjen dhe mbështetjen e Kosovës dhe FSK-së në anëtarësimin në organizatat rajonale të Sigurisë. Nga ana e tij z. Yilmaz premtoi se Turqia do ta ndihmojë FSK-në edhe në të ardhmen në të gjitha drejtimet, qoftë me ngritjen profesionale të kuadrove përmes arsimimit dhe trajnimeve, qoftë përmes donacioneve. Ministri Demolli gjatë qëndrimit në Turqi u takua edhe me personalitete të tjera të larta ushtarake, si dhe vizitojë akademitë dhe shkollat ushtarake dhe kadetët e FSK-së të cilët po studiojnë në Turqi.



Thellohet bashkëpunimi mes Ushtrisë së Turqisë dhe FSK-së



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim komandantin e Forcave Tokësore të Turqisë, gjeneralin Salih Çolak, i cili në krye të një delegacioni të lartë zhvilloi një vizitë zyrtare në Kosovë. Komandanti i Forcave Tokësore të Turqisë u prit me ceremoni ushtarake nga Njësia Ceremoniale dhe Trupa muzikore e FSK-së. Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, falënderoi komandantin e Forcave Tokësore të Turqisë, gjeneralin Çolak dhe përmes tij Qeverinë e Turqisë për përkrahjen e madhe qe ata po japin jo vetëm në fushën e arsimimit, por edhe për mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së me donacione, në kuadër të bashkëpunimit të gjerë mes dy ministrive dhe dy shteteve mike. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama, e njoftoi komandantin e Forcave Tokësore të Turqisë me zhvillimet aktuale dhe sfidat që e presin FSK-në, duke nënvizuar transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK). Gjithashtu gjeneral Rama e njoftoi gjeneralin Çolak edhe lidhur me bashkëpunim e mirë të FSK-së me NATO-n, KFOR-in dhe partnerët tjerë strategjikë. Gjatë këtij takimi gjeneral Ramën e shoqëruan sekretari i përgjithshëm i MFSK-së Shkëlzen Sylaj, gjeneralët ZymerHalimi dhe Gëzim Hazrolli, kurse komandantin e Forcave Tokësore të Turqisë e shoqëruan ambasadorja e Turqisë në Kosovë znj, KivilcimKilic, gjenerali AhmetKirker, etj., Gjatë qëndrimit në Ministri, delegacioni i Ushtrisë së Turqisë u prit edhe nga Ministri i FSK-së, HakiDemolli. Të pranishëm në takim ishin edhe zv. ministrat Fadil Gashi e MuhametLatifi, komandanti i FSK-së gjeneral Rama, gjeneral Hazrolli dhe kolonel Fadil Hadërgjonaj. Ndërkaq, ministri Demolli e falënderoi gjeneralin Çolak, për mbështetjen e vazhdueshme që vendi i tij ka dhënë dhe po jep për FSK-në. ***(Vijon në faqen 3)***

Hungaria mbështet FSK-në në iniciativa rajonale

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli priti zëvendësministrin e Mbrojtjes të Hungarisë, Tamas Vargha, me të cilin diskutoi për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë. Fillimisht ministri Demolli në emër të Ministrisë dhe FSK-së e falënderoi zëvendësministrin e Mbrojtjes të Hungarisë për interesimin e vazhdueshëm që po tregon Ministria e Mbrojtjes së Hungarisë për vazhdimin e thellimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe mbi hapat që do të ndërmerren në vazhdim në drejtim të zyrtarizmit dhe konkretizimit të këtij bashkëpunimi. Ministri Demolli gjithashtu u shpreh se MFSK është angazhuar me seriozitet rreth finalizimit të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë të Mbrojtjes të Hungarisë. Ministri i FSK-së tha se krahas bashkëpunimit me ministritëe Mbrojtjes të shumë vendeve tjera që aktualisht ka Kosova, zyrtarizimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes të Hungarisë ka rëndësi të madhe. Ndërkaq, zëvendësministri i Mbrojtjes të Hungarisë, Tamas Vargha tha gjithashtu se edhe Ministria e tij është në përfundim të punës për finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e FSK-së. Ai premtoi angazhimin e tij të mëtejmë për integrimin e MFSK-së dhe Kosovës në iniciativat rajonale dhe më gjerë.



Gjenerallejtënant Rrahman Rama në vizitë zyrtare në Gjermani

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Zyrës për Bashkëpunim dhe Siguri të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, së bashku me një delegacion të FSK-së, nga data 9 deri më 14 shkurt 2016, qëndroi për një vizitë pune në Komandën Trajnuese të Përbashkët Multinacionale në zonën trajnuese Grafenwoehr në Gjermani. Qëllimi i vizitës së komandantit të FSK-së është pjesëmarrja në Kursin Reagues për Udhëheqje.Gjeneral Rama së bashku me delegacionin e tij u prit nga stafi i lartë i Qendrës trajnuese, ku me këtë rast personeli i Komandës Trajnuese i njoftoi gjerësisht lidhur me sistemin e Kursit Reagues për Udhëheqës. Në këtë Qendër trajnimi po merr pjesë edhe një skuadër e FSK-së, e cila do të zhvillojë trajnime të përbashkëta me skuadrën nga Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, vazhdon vizitën zyrtare në Gjermani deri më 14 shkurt.

Ministri Haki Demolli priti në takim lamtumirës gjeneralin Stefan Fix



Drejtori i Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT) për FSK-në, gjeneral brigade Stefan Linus Fix, në përfundim të mandatit të tij, më 24 shkurt 2016, u prit në takime të ndara lamtumirëse nga ministri i FSK-së zoti Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj dhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli. Me këtë rast, ministri Demolli e falënderoi drejtorin e NLAT-it gjeneralin Fix për kontributin e tij në avancimin dhe të ngritjes profesionale të FSK-së, ku edhe në shenjë respekti për angazhimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë mandatit të tij i dhuroi mirënjohje. Po ashtu gjeneralit Fixi i dhuruan mirënjohje edhe gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Syla dhe zëvendëskomandanti i KFT-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli,me motivacionin për bashkëpunim dhe ndihmë të pakursyer në ngritjen profesionale të FSK-së. Nga ana e tij, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Stefan Linus Fixi i falënderoi ministrin Demolli, komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramën, sekretarin e përgjithshëm të MFSK-së z. Sylaj dhe gjeneral Hazrollin për bashkëpunimin e deritashëm, duke u shprehur njëherësh se ndjehet mjaft i lumtur që pati rastin të punojë bashkë me ta në FSK. Ai po ashtu shprehu bindjen e tij se FSK-ja dhe NLAT-i edhe në ardhmen do të vazhdojnë thëllimin e bashkëpunimit, me qëllim të ngritjes profesionale dhe avancimin e kapaciteteve të FSK-së.

Ministria e Mbrojtjes së Holandës e ndihmon FSK-në

Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramën, më18 shkurt 2016, pritën në një takim pune ambasadoren e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, znj. Gerrie Willems e cila shoqërohej nga atasheu ushtarak i Holandës në Kosovë, nënkoloneli Verbruhg. Me këtë rast, ministri Demolli ka falënderuar ambasadoren Willems për bashkëpunimin dhe ndihmën që Mbretëria e Holandës i ka dhënë ndër vite MFSK-së për edukimin dhe trajnimin ushtarak, veçanërisht ai vlerësoi donacionin e pajisjeve për zhytje të Qeverisë së Holandës dhënë Njësisë së Kërkim-Shpëtimit për ujëra. Nga ana e saj ambasadorja e Holandës në Kosovë, znj. Willems e ka falënderuar ministrin Demolli dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramën për pritjen dhe për bashkëpunimin e mirë që ka Ministria e Mbrojtjes së Holandës me Ministrinë e Mbrojtjes së FSK-së. Krahas kësaj, ajo theksoi se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mes dy vendeve dhe dy ministrive. Ndërsa në Brigadën për Mbështetje Operacionale (BMO) u bë dorëzim-pranimi i donacionit, një sistem rimbushje të baterive, që Ministria e Mbrojtjes së Holandës i ka dhuruar FSK-së. Në fund ambasadorja Willems edhe një herë theksoi se edhe në të ardhmen Holanda do të vazhdojë ta ndihmojë FSK-në në fushën e edukimit, trajnimit dhe stërvitjes.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Haki Demolli priti ambasadoren e Kroacisë, Marija Kapitanovic



Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, më12 shkurt 2016, priti ambasadoren e Republikës së Kroacisë në Kosovë, znj. Marija Kapitanovic. Fillimisht ministri Demolli i uroi ambasadores kroate detyrën e re, dhe pasi i dëshiroi mirëseardhje e falënderoi për ndihmën e vazhdueshme që Kroacia po jep për Kosovën dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.Ministri Demolli, me këtë rast, e njoftoi ambasadoren Kapitanovic me zhvillimet e përgjithshme të Ministrisë që ai drejton, si dhe me zhvillimet e deritashme rreth transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Gjithashtu ministri i FSK-së i shprehu ambasadores Kapitanovic dëshirën e tij për të rritur bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes mes dy vendeve nëpërmjet edukimit dhe trajnimeve të përbashkëta. Nga ana e saj ambasadorja Kapitanovic shprehi kënaqësinë për vizitën e saj në Ministrinë e FSK-së, duke nënvizuar bashkëpunimin e deritashëm në mes dy shteteve, veçanërisht në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë. Ajo vlerësoi lartë sidomos bashkëpunimin e dyanshëm në mes dy forcave, si dhe premtoi rritjen e nivelit të bashkëpunimit në të gjitha fushat që janë me interes edhe për FSK-në. Po ashtu ambasadorja Kapitanovic edhe një herë theksoi se ky bashkëpunim do vazhdojë edhe në të ardhmen në mes dy vendeve dhe dy ministrive.

Komandanti i FSK-së priti në takim lamtumirës komandantin e KFOR-it amerikan



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim (16.02.2016) lamtumirës komandantin e KFOR-it amerikan të Kampit Bondsteel, kolonelin Vernon Simpson me bashkëpunëtorë. Me këtë rast, gjenerallejtënant Rrahman Rama e falënderoi kolonelin Simpson për ndihmën që Ushtria Amerikane e vendosur në Bondsteel po jep për FSK-në dhe në veçanti për Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së në Ferizaj. Koloneli Simpson, prej se ka marrë detyrën e komandantit të KFOR-it amerikan në Bondstell, që nga korriku i vitit 2015, ka rritë nivelin e bashkëpunimit me FSK-në në fushën e trajnimit, arsimimit, planifikimit, mbështetjes logjistike etj. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i dhuroi mirënjohje kolonelit Simpson, me motivacionin për bashkëpunim dhe ndihmë të pakursyer në ngritjen profesionale të FSK-së.Nga ana e tij, koloneli Vernon Simpson e falënderoi komandantin e FSK-së për bashkëpunimin e deritashëm, duke i premtuar thellimin e këtij bashkëpunimi edhe me komandantin e ri në të ardhmen.

Përfaqësuesit e OJQ-së "Fuqia e evropianëve të rinj" u priten nga ministri Demolli



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli më 24 shkurt 2016, priti në Ministri përfaqësues të organizatës joqeveritare,, Fuqia e evropianëve të rinj-FER"(Young europians power-YEP), të prirë nga Alban Mehmeti. Me këtë rast, ministri Demolli i njoftoi të rinjtë e OJQ për misionin e FSK-së, procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, bashkëpunimin e FSK-së me qytetarët, angazhimin dhe përfshirjen e gjinisë femërore në FSK, të minoriteteve etj. Në takimin ishin të pranishëm edhe këshilltarët Rexhep Leci dhe Shkelzen Feka, si dhe zyrtari i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, Agron Durmishi. Të rinjtë e organizatës FER, vizituan edhe Qendrën për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ku u pritën nga komandanti i kësaj qendre, major Avni Kiqina. Gjatë vizitës në QSU, ata u njoftuan nga majori Kiqina lidhur me punën e QSU-së, aktivitetet mësimore, stërvitore, trajnimet, kushtet e akomodimit dhe studimit, si dhe me kalitjen e kadetëve të rinj të FSK-së në këtë qendër. Gjithashtu, të rinjtë OJQ FER, zhvilluan një takim të shkurtër edhe me drejtorin e Departamentit Civilo-Ushtarak, Hajrush Kurtaj. Në përgjithësi, të rinjtë e kësaj organizate u ndanë të kënaqur me vizitën, dhe njëherësh ata falënderuan ministrin Demolli dhe të gjithë ushtarakët dhe zyrtarët e MFSK-së për pritjen dhe mundësinë që ju ofruan për t'u njohur nga afër me zhvillimet, sukseset dhe sfidat e FSK-së. Organizata joqeveritare "Fuqia e evropianëve të rinj" është organizatë e fokusuar në ngritjen e vetëdijes qytetare, sidomos në ndërgjegjësimin e moshave të reja për forcimin e shtetit, e cila aktivitetin e saj e zhvillon përmes fushatave, publikimeve, ligjëratave dhe informimit të publikut me situata të ndryshme në shumë sfera.

Thellohet bashkëpunimi mes Ushtrisë së Turqisë dhe FSK-së

(Vijon nga faqja 1)

Ministri po ashtu e njoftoi gjeneralin Çolak me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me zhvillimet rreth transformimit të FSK-së në FAK. Nga ana e tij, gjenerali Çolak falënderoi ministrin Demolli dhe gjeneral Ramën për pritjen e përzemërt. Ai njëherësh premtoi thellimin e bashkëpunimit në mes Ushtrisë së Turqisë dhe FSK-së, si dhe angazhimin e vendit të tij në përkrahjen e Kosovës dhe të FSK-së drejt anëtarësimit në organizmat ndërkombëtarë dhe në NATO. Në fund drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral ZymerHalimi, përmes një informimi të shkurtër e njoftoi delegacionin ushtarak nga Turqia me strukturën, shkollimin, trajnimet rajonale, pjesëmarrjen e FSK-së në operacionet e shpëtimit në shtetet fqinje, për bashkëpunimin me NATO-n, KFOR-in, si dhe partneritetin me Gardën Kombëtare të Ajovës.Të pranishëm në takim ishin edhe gjeneralët: Bashkim Jashari e NazmiBrahimaj, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, z. FarukGeci, kolonelët Ilir Qeriqi dhe NaimHaziri, etj.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë thellojnë bashkëpunimin



Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Shkelzen Sylaj, me bashkëpunëtorë më24 shkurt 2016, ka qëndruar në Tiranë, përnjëvizitë pune në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, ku është pritur nga homologu i tij shqiptar, Arian Kraja. Sekretari Syla shoqërohej nga gjeneral Nazmi Brahimaj, shef i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve si dhe nga atasheu i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës në Tiranë, nënkolonel Enver Dugolli. Gjatë vizitës së tyre u pritën edhe nga Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneral Jeronim Bazo. Gjatë takimit dypalësh në Ministrinë e Mbrojtjes në Tiranë, të dy sekretarët diskutuan për fushat e bashkëpunimit të deritanishëm dhe zbatimin e "Protokollit mbi bashkëpunimin dhe asistencën në fushën e integrimit euro-atlantik dhe rajonal" si dhe zbatimin e "Protokollit mbi bashkëpunimin në fushën e arsimimit dhe trajnimit ushtarak". Me këtë rast është bërë edhe nënshkrimi i planit dypalësh të bashkëpunimit për vitin 2016. Ne emër të MFSK-së plani është nënshkruar nga kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, ndërsa nga pala shqiptare nga z. Igli Hasani, drejtor i Politikave Strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.Në këtë plan bashkëpunimi, ndër të tjera, janë paraparë të zhvillohen takime dhe vizita zyrtare, shkëmbim përvojash, organizim dhe pjesëmarrje në seminare dhe konferenca, kurse dhe trajnime nga niveli bazik deri tek niveli i avancuar. Në delegacionin zyrtar gjatë vizitës dhe takimeve të sekretarit të përgjithshëm, zotëri Sylaj, në Ministrinë e Mbrojtjes në Tiranë, ishin edhe Azem Smajli- drejtor i Departamentit për Politika dhe Plane, kolonel Irfete Spahiu- zëvendëskomandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, Krenare Sogojeva - Dërmaku, drejtor i Departamentit Ligjor, Florin Hoxha- sekretar personal i sekretarit të përgjithshëm të MFSK-së.

Ambasadorja e Republikës së Turqisë vizitoi Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjeve të FSK-së

Zëvendëskomandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), kolonel Irfete Spahiu, në ambientet e kazermës "Skënderbeu" në Ferizaj, priti më 26 shkurt 2016, në një vizitë zyrtare ambasadoren e Turqisë në Republikën e Kosovës, znj. K?v?lc?m Kiliç. Gjatë kësaj vizite znj. Kiliç u informua nga zëvendëskomandantja Spahiu me misionin, aktivitetet, trajnimet, stërvitjet dhe edukimin dhe arsimimin aktual që kryhen në ambientet e KDS-s. Po ashtu, gjatë këtijtakimi u bisedua edhe për bashkëpunimin dypalësh në mes të Forcave të Armatosura të Turqisë në Kosovë me Forcën e Sigurisë së Kosovës e veçanërisht me KDS-në, si dhe mundësitë e ndryshme të vazhdimit dhe avancimit të mëtutjeshëm të këtij bashkëpunimi. Pas këtij takimi, e shoqëruar nga kolonel Spahiu dhe stafi i KDS-së, ambasadorja turkeznj. Kiliç vizitoi ambientet e Qendrës së Stërvitjes Kolektive (QSK) ku u njoh për së afërmi me aktivitetet që ofron kjo Qendër Stërvitore për KDS-në dhe njësitë e FSK-së. Gjithashtu, ajo vizitoi edhe Qendrën e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve (QZHPU) më saktësisht Kursin e Gjuhës Turke të cilin e ndjekin pjesëtarët e FSK-së, ku pati rastin të bisedoi me pjesëmarrësit e këtij kursi dhe të shoh nga afër të arriturat dhe përparimet e pjesëtarëve të FSK-së për sa i përket mësimit të gjuhës turke. Ambasadorja Kiliç u nda mjaft e kënaqur me nivelin e arritur të pjesëtarëve në këtë kurs si dhe shprehu gatishmërinë për mbështetjen e mëtutjeshme të nevojshme për KDS-në në përgjithësi, si dhe kursin e gjuhës turke në veçanti. Në fund të takimit, të dyja palët shprehën gatishmëri të plotë për vazhdimin dhe avancimin e bashkëpunimit dypalësh në shumë fusha.

FSK-ja parakaloi në tetë vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Ministri i FSK-së Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtënantë Rrahman Rama dhe stafin e lartë të Ministrisë dhe FSK-së, shënimin e tetë vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës e nisen me homazhe në Memorialin e komandantit legjendar Adem Jashari në Prekaz, të cilët në shenjë nderimi vendosën kurora me lule të freskëta dhe bënë homazhe.

Manifestimi qendror për shënimin e përvjetorit të pavarësisë u mbajt në sheshet "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti". Në manifestim morën pjesë presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, kryeministri i Kosovës Isa Mustafa, zëvendëskryeministri Hashim Thaçi, ministri i FSK-së zoti Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ministra, zëvendëskryeministra, ambasadorë dhe atashe të akredituar në Kosovë, deputetë dhe qytetarë të shumtë të Kosovës. "Kjo është dita më e shënuar e historisë së Kosovës që përmbledh sakrificën, mençurinë e përkushtimin për ta jetësuar idealin e gjeneratave të tëra për një shtet" tha në fillim të fjalës së saj, presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, për të shtuar se: "Tetë vjet që prej shpalljes së pavarësisë ne përkujtojmë idealet që na bëjnë bashkë, përkushtimin për lirinë dhe për zhvillimin e vendit tonë, për demokracinë që ndërtohet çdo ditë dhe njëkohësisht edhe për paqen". Presidentja Jahjaga përshëndeti edhe FSK-në për punën që po bën në ndërtimin e një force të re. "Sot është festë për ju pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që keni përmbledhur me sukses prej shumë muajsh punën tuaj në ndërtimin e një force të re mbrojtëse e që po prisni, ashtu si edhe të gjithë qytetarët e tjerë, ta realizoni ëndrrën tuaj. Forca e Armatosur e Kosovës është e ardhmja e juaj, e ardhmja jonë e përbashkët, e ardhmja e shtetit të Kosovës". Në fund, presidentja e Kosovës vlerësoi se Pavarësia e Kosovës është garantuese e paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajonin e Evropës Juglindore.

Ndërsa kryeministri i Kosovës Isa Mustafa, në fjalën e tij, në përvjetorin e shënimit të 8- vjetorit të Pavarësisë së Kosovës përmblodhi të arriturat e përgjithshme të Republikës së Kosovës. "Kjo ditë është kurorëzim i aspiratës për liri, pavarësi dhe demokraci, është ditë e përkujtimit të sakrificës së shumë gjeneratave që u flijuan për këtë ide dhe dëshmorëve e martirëve të vendit të bekuar. Këto 8 vjet, ne kemi demonstruar përkushtim për ta bërë Kosovën një vend të denjë për të jetuar. Kemi dëshmuar përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe jemi përpjekur të njohim e zbatojmë obligimet tona ndaj fqinjëve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Shënimi i përvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës u përmbyll me parakalimin e kuadrateve të FSK-së dhe të njësive të Policisë së Kosovës.















FORCA JONË

Intervistë me kolonelin britanik David Jones, këshilltar i komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës, para se ai të largohej nga Kosova

Kolonel David Jones: E ardhmja për FSK-në do të jetë shumë e mirë

Gazeta "Forca Jonë": *Kolonel, para dy vitesh keni ardhur në Kosovë/FSK, së pari si këshilltar i gjeneral Kastratit dhe më pastaj i gjeneral Ramës, cilat janë përshtypjet tuaja të para atëherë dhe tani?*

Kolonel David Jones: Përshtypjet e mia të para ishin jashtëzakonisht pozitive që nga fillimi. Unë jam nga ata njerëz që e shoh gotën gjysmë të mbushur dhe jo gjysmë të zbrazur. FSK-ja është një organizatë me pjesëtarë të pasionuar të cilët vërtetë përpiqen të bëjnë më të mirën kurdo kur kanë mundësi. Shumë prej tyre janë plot entuziazëm dhe të përkushtuar, edhe pse ndonjëherë ju mungon përvoja dhe njohuritë ata mundohen të bëjnë me të mirën e tyre.Gjatë këtyre dy viteve shoh se FSK ka bërë një zhvillim të mirë, duke ndërtuar kapacitetet e saj dhe duke zhvilluar shkathtësitë dhe njohuritë me synim të krijimit të Forcës së Armatosur. Jam ndier i kënaqur gjatë punës time me të dy gjeneralët, të cilët ishin oficerë të lartë shumë profesionalë dhe liderë, po ashtu edhe shumë njerëzorë, që gjithmonë kanë punuar për të mirën e FSK-së dhe të Kosovës.

Gazeta "Forca Jonë": *MFSK dhe FSK kanë një bashkëpunim të mirë me Armatën britanike çfarë mund të na thoni në këtë pikëpamje?*

Kolonel David Jones: Populli i Kosovës ka një marrëdhënie të ngushtë me popullin britanik në veçanti që nga viti 1999 dhe sot kjo reflektohet në marrëdhëniet e Armatës britanike me FSK-në. Britania e Madhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me FSK-në duke deklaruar se do ta ndihmojë FSK-në në fusha të caktuara dhe po aq samunden edhe në fusha të tjera.Nga ky bashkëpunim i ngushtë tani kanë dalë 13 pjesëtarë të FSK-së të diplomuar në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst (RMAS). Vlen të përmenden; nëntogeri Ismail Hoxha i cili fitoj shpatën ndërkombëtare më 15 dhjetor; zyrtarë të lartë të FSK-së ndjekin kolegjin e studimeve për mbrojtje (RCDS) në Londër; mbështetje trajnimeve gjuhësore në Kosovë dhe Britani; trajnime mjekësore; mbështetje bendit të FSK-së; mbështetje inxhinierike mbretërore; trajnimi i këmbësorisë me vizita nëpër ekipe trajnimi ose individ që shkojnë në Britani. Të mos harrojmë mbështetjen e përditshme që pozita ime i ofron komandantit të FSK-së dhe ekipit të tij të lartë udhëheqës.

Gazetë "Forca Jonë": *Kolonel, ju si këshilltar i komandantit të FSK-së në çfarë mënyrash tjera i keni kontribuar profesionalizimit të FSK-së?*

Kolonel David Jones: Gjithmonë jam përpjekur t`i shtojë vlera rolit tim. Jam përpjekur t`i inkurajoj për pjesëmarrje me të madhe në sport në gjithë FSK-në dhe isha forcë lëvizëse prapa krijimit të 11-shës së FSK-së përveç ekipit të futbollit që ka luajtur kundër Forcave të Armatosura të vendeve të tjera fqinje, përfshirë edhe Shqipërinë dhe Malin e Zi.Kjo ishte për të ndihmuar bashkëpunimin nëpërmjet sportit, përtej kufijve ndërkombëtarë, me qëllim të rritjes së respektit për të tjerët. Një nismë tjetër ishte sporti dhe rritja e fondeve për organizatat bamirëse lokale dhe ishte kyç për futjen e FSK-së në 10 km në Gjakovë ku u pa një pjesëmarrje e madhe me rreth 800 vrapues dhe shtimin e disa mijë euro për organizatat bamirëse të fëmijëve lokalë. Kjo i ndihmoi po ashtu ngritjes së profilit të sportit për të gjithë dhe për FSK-në si një organizatë të mirë dhe ende si një pjesë e një komunitetit më të gjerë.

Gazetë "Forca Jonë": *Pas dy vitesh shërbimi në FSK, po largoheni nga Kosova, cilat janë përshtypjet tuaja ?*

Kolonel David Jones: Profesionalisht dhe personalisht ka qenë një eksperiencë fantastike të cilën do ta ruaj në kujtesën time për një kohë të gjatë. Shpresoj se kam ndikuar tek një pjesë e madhe në FSK që të mbështeten oficerët e rinj përmes trajnimeve, po ashtu shpresoj të kem ndikuar në shoqërinë kosovare që të mbështetet ngritja e fondeve të bamirësisë për fëmijët si dhe qasja për strehimin e qenve.

Gazetë "Forca Jonë": *Kolonel, si e shihni përparimin e FSK-së gjatë shërbimit tuaj në Kosovë?*

Kolonel David Jones: Gjatë kohës tim në FSK kam pasur shumë gjëra të mira të cilat gjithmonë kanë qenë të rëndësishme dhe të këndshme. Pjesëmarrja e personelit të FSK-së për herë të parë në ushtrimet e NATO-s, kësaj radhë me Marinën Mbretërore; për herë të parë pjesëmarrja e udhëheqjes së lartë të FSK-së në Kolegjin Mbretërore të Studimeve për Mbrojtje; nënoficeri i parë i FSK-së me nacionalitet serb merr pjesë në trajnimin për gjuhë angleze në Britani të Madhe; fituesi i parë i shpatës ndërkombëtare të Akademisë Mbretërore Ushtarake Sandhurst nga i gjithë rajoni; loja e parë në futboll e FSK-së jashtë vendit; organizimi i parë i FSK për vrapim 10 km; për herë të parë pjesëmarrës të trajnimit BMATT në Republikën Çeke dhe lista vazhdon. Unë besoj që FSK-ja në të ardhmen do të bëhet FAK por ende ka sfida përpara për arritjen e këtij misioni, veçanërisht në sferën politike.



Gazetë "Forca Jonë": *Cili është mesazhi juaj për lidershipin e FSK-së ?*

Kolonel David Jones: Unë besoj që lidershipi i FSK-së vazhdimisht po punon shumë për një FSK më të mirë. Është shumë e rëndësishme qe ata t'i përkrahin gjeneratat e reja të oficerëve dhe nënoficerëve të cilët janë trajnuar brenda dhe jashtë Kosovës. Ata janë e ardhmja dhe ardhmja duket të jetë shumë e mirë për FSK-në. Shpresojmë që në një të ardhme sa më të afërt të transformohen në Forca të Armatosura, pasi që ka shumë oficerë dhe nënoficer të rijnë të shkëlqyer në pritje për të ndryshuar dhe udhëhequr FSK-në dhe Kosovën drejt një të ardhme me të ndritur.



FSK-ja dhe KFOR-i demolojnë mbi 50 mjete të pashpërthyera

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht të Kompanisë së Deminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile, në bashkëpunim me pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit të KFOR-it amerikandhe atij zviceran, më21 shkurt 2016, në poligonin e gjuajtjes së KFOR-it në Rahovec demoluan mbi 50 mjete të pashpërthyera të kalibrave të ndryshme.

Këto mjetejanë gjetur nga Kompania e Deminimit gjatë operacioneve të saja të pastrimit të hapësirave të territorit të Kosovës, të kryera gjatë vitit 2015-2016.

Zëvendëskomandanti i Kompanisë së Deminimit, kapiten Gëzim Sadau shpreh mjaft i kënaqurme punën epjesëtarëve të Kompanisë së Deminimit dhe me sukseset e tyre në këtë drejtim: Pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit deri tani kanë pastruar një pjesë të madhe të territorit të Kosovës, ku kanë hasur në një numër të madh të mjeteve të rrezikshme, shumë prej të cilave ekzistojnë që nga lufta e fundit në Kosovë dhe disa të tjera ekzistojnë qysh prej Luftës së Dytë Botërore. Sot kemikryer rreth 20 demolime ku janë shkatërruar mbi 50 mjete të ndryshme të pashpërthyera", ka thënë kapiten Sada.Ai është shprehur i kënaqur edhe më bashkëpunimin që kjo Kompani ka me pjesëtarët e KFOR-it amerikan dhe atij zviceran, veçanërisht ai vlerësoi lart përfitimet që pati kompania e tij gjatë shkëmbimit të përvojave të shumta me këto dy shtete. Ndërsa Wayne Brown, rreshter i parë i njësitit 666 për shkatërrimin e mjeteve të pashpërthyera eksplozive me grupin shumëkombësh të betejës lindje në KFOR-in amerikan, u shpreh se ndjehet mjaft i kënaqur me bashkëpunimin me FSK-në. "Kam marr pjesë në rreth 20 demolime të bëra në Kosovë në bashkëpunim me pjesëtarët e FSK-së, dhe jam i bindur se të dy palët kemi mësuar shumë nga eksperiencat e njëri- tjetrit. Pjesëtarët e FSK-së janë mjaft të sigurt në punën e tyre për demolimin e mjeteve të pashpërthyera, dhe gjithherë janë treguar të aftëgjatë ballafaqimit të tyre me situata të ndryshme", ka thënë Brawn. I kënaqur nga ky bashkëpunim u shpreh edhe kapiteni Stefan Buhler, nga Kompania e Deminimit e KFOR-it zviceran, i cili është në Kosovë qysh nga tetori i vitit 2015. "Për ne kjo përvojë me pjesëtarët e FSK-së nuk është vetëm një bashkëpunim në fushën e demolimit të mjeteve të rrezikshme, por është edhe një lloj i ushtrimeve të përbashkëta të FSK-së me amerikanët". Pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë së Kosovësqysh prej vitit 2010-2015 u janë përgjigjur 1800 detyrave, ku kanë bërë pastrimin e 1,425,401 metrave dhe gjithsej kanë hasur në 5205 mjete të pashpërthyera.

Instruktorët e Universitetit Amerikan mbajtën trajnimin "Menaxhimi i Kontratave"

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt ceremonia e certifikimit të dhjetë pjesëtarëve të FSK-së, të cilët ndoqën trajnimin "Menaxhimi i Projekteve" nga instruktorët e Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK) nga data 27. 01.2016 deri më 19. 02. 2016. Ky trajnim u realizua në bazë të marrëveshjes së Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe niversitetit Amerikan në Kosovë (AUK), si dhe në bazë të planit për trajnime të G9-KFT-së, për ngritjen profesionale të pjesëtarëve në fushën e menaxhimit të projekteve humanitare.Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm edhe komandanti i Njësisë së Reagimit në Kriza (NJNRK), nënkolonel Milaim Musliu dhe zëvendësshefi i Operativës së Komandës së Forcave Tokësore, nënkolonel Fidaim Elshani.Me këtë rast, nënkolonel Elshani në emër të Shefit të Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) falënderoi instruktorët e AUK-ut për bashkëpunimin dhe trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së."Ju falënderoj dhe ju përgëzoj për këtë trajnim mjaft të rëndësishëm për ne, dhe njëherëshjam mjaft i kënaqur që pjesëtarët tanë patën mundësi të përfitojnë nga eksperienca juaj e jashtëzakonshme në këtë fushë ",- ka thënë ndër të tjera Elshani . Ndërsa pjesëmarrësit e këtij trajnimi i përgëzoi instruktorja nga AUK-u Hana Qerimi, e cila u shpreh mjaft e kënaqur me mbarëvajtjen dhe interesimin e pjesëmarrësve gjatë këtij trajnimi.

U mbajt trajnimi “Menaxhimi i Fatkeqësive” në FSK

Në kazermën "Adem Jashari "të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, më 12 shkurt 2016,përfundoi trajnimi njëjavor "Menaxhimi i Fatkeqësive",i realizuar nga ekipi i instruktorëve të Gardës Kombëtare të Ajovës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë trajnim morën pjesë 15 pjesëtarë: tetë nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), pesë nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe dy nga Policia e Kosovës. Fillimisht, instruktori i Gardës Kombëtare të Ajovës, koloneli Adams i njoftoi të pranishmit me ecurinë e trajnimit. Ai njëherësh shprehu kënaqësinë e tij për suksesin që pjesëmarrësit treguan gjatë këtij trajnimi.Ndërsa, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, falënderoi instruktorët për vullnetin dhe gatishmërinë e tyre në mbështetje të



FSK-së.

"Shfrytëzoj rastin të falënderoj ekipin e instruktorëve nga Ajova, që na mundësuan shkëmbimin e përvojave të tyre të cilat janë mjaft të rëndësishme për vendin tonë, duke pasur parasysh eksperiencat e jashtëzakonshme që ka shteti i Ajovës me fatkeqësi të ndryshme natyrore",ka thënë gjeneral Hazrolli. Ai falënderoi edhe komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralin Orr, për bashkëpunimin e deritashëm dhe u shpreh i bindur se ky bashkëpunim do të thellohet në të ardhmen.Në fund të ceremonisë, gjeneral Hazrolli, në shenjë respekti për punën e instruktorëve amerikanë ndau për ta mirënjohje, ndërsa për pjesëmarrësit e trajnimit certifikata.

Pjesëtarët e FSK-së dhuruan mbi 700 doza gjak për qytetarët e Kosovës



Të premten, më 12 shkurt 2016, përfundoi aksioni humanitar për dhurimin e gjakut, i cili u realizua nga data 1-12 shkurt 2016, në Ministrinë e Forcës së Sigurisë dhe në të gjitha njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), me moton "Një pikë gjak për shpëtimin e një jete". Aksioni u organizua nga Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Departamenti i Mjekësisë i MFSK-së dhe u realizua nga QKTGJK dhe Kompania e Mjekësisë e FSK-së. Ministria dhe FSK-ja kanë traditë në organizimin e dhurimit humanitar të gjakut. Vetëm gjatë aksionit të parë, për këtë vit, janë mbledhur mbi 700 doza gjak, të cilat do të jenë në shërbim të të gjithë qytetarëve të cilët kanë nevojë për të. Pjesëtarët e FSK-së, me këtë aksion kanë dhënë shembullin më të mirë në ndihmë të qytetarëve, i cili padyshim ka ndikuar edhe në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për t'iu përgjigjur aksioneve të ndryshme humanitare dhe iniciativave të tilla siç ishte edhe kjo.Dr. Bahrije Halili-Gjocaj, udhëheqësja e këtij aksioni humanitar u shpreh se pjesëtarët e FSK-së janë shembull për dhurimin vullnetar të gjakut. Ata janë donatorë të rregullt që gjithherë me vullnet i janë përgjigjur këtij aksioni, jo vetëm gjatë organizimeve të rregullta por edhe jashtë tyre, u shpreh në fund doktoresha Bahrija. Ndërsa, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në MFSK, Harjush Kurtaj, falënderoi pjesëtarët e FSK-së për gatishmërinë e treguar gjatë këtij aksioni dhe për ndihmën e tyre të vazhdueshme në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Në kursin për media u certifikuan 12 pjesëtarë të FSK-së

Në ambientet e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës u certifikuan 12 pjesëtarë të FSK-së të rangjeve të ndryshme, për komunikim me media, si pjesë e programit të Qendrës bazike të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS). Kursi për media, cikli i gjashtë me radhë, të cilën e ndoqën 12 pjesëtarë të FSK-së të të gjitha njësive të Forcës së Sigurisë u zhvillua për pesë ditë me radhë, në të cilin pjesëmarrësit ndoqën ligjërata dhe pjesë praktike me ushtrime grupore dhe individuale. Gjatë zhvillimit të kursit ishte për vizitë drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi, i cili shprehu admirimin e tij për punën e trajnerëve me kursantët, si dhe kënaqësinë që pjesëtarët e FSK-së po marrin njohuri nga fusha e komunikimit me media dhe se këta pjesëtarë do të dinë që punën dhe sukseset e FSK-së t'i prezantojnë para publikut kur atyre iu kërkohet. Gjeneral Halimi gjithashtu u dorëzoi të gjithë kursantëve certifikata për përfundimin me sukses të kursit. Me këtë trajnim pjesëmarrësit përgatiten për komunikim me mediat dhe në veçanti se si të shpërndajnë mesazhin kryesor, si të duken para mediave, si të komunikojnë me gazetarët si dhe në përgjithësi mbi rolin e mediave në demokraci e gjithashtu edhe mbi rëndësinë e përdorimit të mediave sociale. Programi i trajnimit udhëhiqet dhe zhvillohet që nga viti 2014 nga trajnerët: Ibrahim Shala-drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, major Remzie Zeqiraj-oficere për Marrëdhënie me Publikun në MFSK dhe asistent trajneri, major Vëllazërim Qerimi-shef i Zyrës për Informim në Komandën e Forcave Tokësore(KFT), trajnerë të



Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës të certifikuar nga Qendra Regjionale për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Norvegjisë dhe Ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë.

22 pjesëtarë të BRSH-së kryejnë trajnimin "Personi i Parë në Vendngjarje"

Në kazermën ,,Minatori" të FSK-së në Mitrovicë, më 26 shkurt 2016, është mbajtur certifikimi i pjesëtarëve që kanë përfunduar trajnimin "Personi i Parë në Vendngjarje", i cili u realizua prej datës 15 deri në 26 shkurt 2016. Ky trajnim është në vazhdën e përgatitjeve të pjesëtarëve të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) për pjesëmarrjen në garën ndërkombëtare "CambrianPatrol", që do të mbahet në Britani të Madhe, e ku do të marrin pjesë 100 skuadra nga të gjitha vendet e botës. Këtë vit, për herë të parë, është ftuar të marrë pjesë edhe një skuadër nga Kosova. Përgatitja e pjesëtarëve për garën "CambrianPatrol" ka filluar të realizohet në Batalionin e Tretë të BRSH-së në Mitrovicë së bashku me ekipin e Ushtrisë së Britanisë së Madhe për Këshillim dhe Trajnim-BMAT. Në ceremoninë e diplomimit ishin të pranishëm komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, nënkolonel AndyLeyton nga Ekipi i Ushtrisë së Britanisë së Madhe, komandanti i Batalionit të Tretë, major Beton Retkoceri, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, pasi falënderoi ekipin e Ushtrisë së Britanisë i përgëzoi pjesëtarët e Batalionit për angazhimin, motivimin dhe profesionalizmin e treguar dhe njëherësh shprehu dëshirën e tij për të shtuar intensitetin trajnimeve edhe në të ardhmen. Ndërkaq, ekipi i Ushtrisë së Britanisë së Madhe vlerësoi lart motivimin dhe angazhimin e të gjithë pjesëmarrësve gjatë këtij kursi, të cilët, siç u shprehen ata, e dëshmuan me suksesin që treguan gjatë testimit. Gjatë përgatitjeve të skuadrës për garën "CambrianPatrol" pjesëmarrësit seleksionohen në bazë të performancës që tregojnë gjatë trajnimeve të avancuara.



FOTO-LAJM



Kompania 2C e Batalionit të Dytë të BRSH-së realizoi trajnimin taktik "Panteri 1"

Pjesëtarët e Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të Kompanisë 2 C, realizuan me sukses më 26 shkurt 2016 trajnimin taktik 24 orësh "Mbijetesa në kushte ekstreme dhe marshimin taktik sfidues" të koduar "Panteri-1" në bjeshkët e Istogut, ku lartësia mbidetare ishte 1800 metra.

Varroset me nderime të larta ushtarake kapter Emin Bushi

Kapter Emin Isa Bushi më 19 shkurt 2016, u varros me nderime të larta ushtarake në fshatin e tij të lindjes në Pustenik të Hanit të Elezit. Nënoficeri i FSK-së u përcoll për në banesën e tij të fundit nga togu ceremonial i Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, kolegët e tij, familjarë e veteranë, si dhe nga shumë qytetarë të Kosovës. Në ceremoninë mortore ishin të pranishëm zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale kolonel MuharremRrahmani, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel ShaipHaziri, si dhe oficerë dhe nënoficerë të shumtë të FSK-së.Në emër të FSK-së, kolonel ShaipHaziriu shprehu ngushëllime të sinqerta familjes, shokëve dhe kolegëve. Ai për veprën e EminBushit, pos tjerash tha: "Si komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile ndjej krenari të madhe kur kujtoj se nga duart e specialistit të Njësisë së Deminimit, kapter Emin Bushi, janë pastruar dhe siguruar me mijëra metra katrorë sipërfaqe të minuara". Në fund të ceremonisë



familjes Bushi iu dorëzua Flamuri i Republikës së Kosovës me të cilin trupi i Eminit u përcoll për në banesën e fundit. Emin Bushi u lind më 21.07.1971 në fshatin Pustenik-Komuna Hani i Elezit. Shkollimin fillor e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa atë të mesëm në Kaçanik-drejtimi Makineri. Emini ishte pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ku veproi në Brigadën 164 "GafurrLoku". Pas transformimit të UÇK-së inkuadrohet në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në Batalionin 36-të të Xhenios. Emini si pjesëtar i TMK-së veproi edhe në Kompaninë e Deminimit në kuadër të Brigadës së Mbrojtjes Civile (BMC) të TMK-së. Pas transformimit të TMK-së në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) punoi në Regjimentin e Mbrojtjes Civile-Kompaninë e Deminimit. Si pjesëtar i FSK-së, Emini ka dhënë një kontribut të çmuar në sigurinë e jetës së qytetarëve të Kosovës, duke bërë pastrimin e fushave të minuara dhe shkatërrimin e mjeteve të rrezikshme kudo në Kosovë. Emin Bushi ndërroj jetë më 18 shkurt 2016 pas një sëmundje të rëndë, duke lënë pas bashkëshorten dhe djalin-Taulantin.

FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 45 • Prill 2016 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Presidentja Jahjaga: FSK krenaria e Republikës së Kosovës

Komandantja supreme e Forcës së Sigurisë(FSK), presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga më 16 marsu prit nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahaman Rama dhe ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë, Haki Demolli për vizitë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë(MFSK) dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, në prag të përfundimit të mandatit të saj si presidente e vendit. Nikoqiri, gjenerallejtënant Rrahman Rama në takimin me presidenten Jahjaga e ku ishin të pranishëm edhe ministri Haki Demolli dhe gjeneralët Zymer Halimi dhe Gëzim Hazrolli, fillimisht e ka falënderuar presidenten Jahjaga për bashkëpunimin, koordinimin dhe angazhimin e saj për FSK-në, gjatë mandatit si Komandante supreme. Me këtë rast, gjeneral Rama e ka njoftuar Presidenten në përgjithësi mbi zhvillimin, profesionalizimin, bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar, operacionet dhe aktivitetet, trajnimet dhe shkollimet si dhe mbi procesin e përgatitjeve që FSK-ja është duke zhvilluar në mënyrë që vendimi i institucioneve më të larta të vendit për transformim të FSK-së në Forca të Armatosura, apo ndryshimi i misionit të saj ta gjej institucionin të përgatitur për një transformim profesional. Presidentja e vendit, Atifete Jahjaga e ka përgëzuar gjeneral Ramën si dhe ministrin Demolli për komandimin dhe menaxhimin me sukses të FSK-së dhe Ministrisë. E para e vendit tha se Forca e Sigurisë së Kosovës është institucioni i cili ka arritur që edhe në nivel të rajonit dhe më gjerë të prezantojë shumë suksesshëm si Kosovën ashtu dhe Forcën e saj. Komandantja e përgjithshme, gjatë takimit në ministri, tha se Republika e Kosovës është duke ndërtuar një Forcë gjithëpërfshirëse duke përsëritur se synimi ynë është që Kosova të bëhet anëtare e NATO-s. Në fund presidentja e vendit, zonja Jahjaga falënderoi gjeneral Ramën, dhe nëpërmjet tij të gjithë oficerët, nënoficerët dhe ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës për shërbimin ndaj vendit duke shtuar se FSK-ja është krenaria e Kosovës, institucioni më i besueshëm në vend për të gjithë qytetarët e Kosovës. Pas takimit, presidentja Jahjaga në një koktej rasti takoi dhe bisedoi me shumë kadetë, ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të FSK-së.



Ministri Haki Demolli priti ministrin e Mbrojtjes së Kroacisë, Josip Buljeviç



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli më 7 mars 2016, priti në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes (MM) të Republikës së Kroacisë, Josip Buljeviç me bashkëpunëtorë. Ministri Buljeviç dhe delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë u pritën në Ministrinë e Forcës së Sigurisë me ceremoni solemne shtetërore, ku ishte e rreshtuar Garda ceremoniale e FSK-së si dhe Orkestra frymore e cila ekzekutoi himnet e të dyja shteteve, atë të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Kroacisë. Fillimisht të dy ministrat, Demolli dhe Buljeviç, zhvilluan një takim kokë me kokë, në të cilin u bisedua për marrëdhëniet e mira ndërmjet të dyja vendeve, dy ministrive si dhe për gatishmërinë për intensifikimin dhe thellimin e këtyre marrëdhënieve në të ardhmen. Pastaj, ministri i FSK-së, Haki Demolli dhe ministri kroat i Mbrojtjes, Josip Buljeviç kryesuan delegacionet e tyre në një takim të zgjeruar në të cilin u shpalos perspektiva e marrëdhënieve dy paleshe në mes MFSK-së dhe MM-së të Kroacisë.Ministri Demolli, pasi i uroi ministrit Buljeviç detyrën e re të ministrit, i shprehu atij falënderimin për angazhimin e Kroacisë dhe ushtarëve të saj në kuadër të KFOR-it, për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kroate po japin si në aspektet e shkollimit, trajnimit dhe ngritjes profesionale të oficerëve, nënoficerëve dhe kadetëve të Forcës së Sigurisë, në shkollat, qendrat trajnuese dhe në Akademinë e Mbrojtjes kroate.Ministri i FSK-së gjatë takimit i shprehu ministrit kroat të Mbrojtjes përkushtimin e MFSK-së dhe Kosovës për t'i thelluar marrëdhëniet miqësore me Kroacinë, duke e theksuar faktin se marrëdhëniet me Kroacinë janë të të njëjtit nivel me Shqipërinë, ShBA-në (Aiovën), Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë dhe Turqinë. Ministri Demolli gjithashtu gjatë takimit e informoi ministrin Buljeviç edhe lidhur me procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura(FAK), si dhe kërkoi nga Ai mbështetje dhe përkrahje për Kosovën në rrugën e saj drejt anëtarësimit në iniciativa ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes me theks në "Adriatik 5", RACVIAC, e në organizma tjerë ndërkombëtarë, në të cilat Kosova ende nuk është anëtare. Në fund ministri Demolli u shpreh se Republika e Kosovës, Republika e Kroacisë si dhe disa shtete tjera mike në rajon mund të ndërtojnë një „mozaik" paqeje, bashkëpunimi dhe stabiliteti në këtë pjesë të Evropës, duke u shprehur se Kosova është shumë e përkushtuar në ndërtimin e miqësisë me shtetet e rajonin tonë.Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, Josip Buljeviç u shpreh se vizita e tij e parë në Republikën e Kosovës, prej që ai ka marrë detyrën e ministrit të Mbrojtjes, është bërë me qëllim për të dhënë mesazhin se Kosova është e rëndësishme për Republikën e Kroacisë.Krahas kësaj, ministri kroat u shpreh se urë lidhëse mes Kroacisë dhe Kosovës janë edhe pakica shqiptare që jeton në Kroaci, e cila është e integruar mjaft mirë, pastaj kontributi i shqiptarëve në ditët më të vështira për Kroacinë si dhe historia jonë e përbashkët. Ai, tregoi gjithashtu se nesër do të vizitojë edhe Prekazin, pikërisht për shkak të kësaj historie të ngjashme dhe se në delegacion ka edhe këshilltarin për çështje të veteranëve të presidentes kroate. Ministri kroat i Mbrojtjes, Buljeviç tha gjithashtu se Kroacia dhe Kosova nuk kanë çështje të hapura dhe se i vetmi „interes" i Kroacisë ndaj Kosovës është që ta shoh këtë vend mik të qëndrueshëm, duke shtuar se bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve do të vazhdojë dhe se fushat në të cilat mund të bashkëpunohet janë të pakufizuara. Ministri Buljeviç tha gjithashtu se Kroacia e sheh Kosovën të integruar në Bashkimin Evropian dhe në NATO, dhe për këtë keni mbështetjen edhe të ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë dhe të shtetit të Kroacisë dhe kjo do të arrihet nëse Kroacia dhe Kosova do të punojnë për një strategji të përbashkët. *(Vijon në faqen 3)*

Në FSK u mbajt manifestimi qendror 'Epopeja e UÇK-së'

Manifestimi qendror në kuadër të shënimit të "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", nën patronatin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, u mbajt në kazermën „Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Prishtinë. Në ceremoninë e sotme në FSK, ishin të pranishëm: Presidentja Atifete Jahjaga, krye-parlamentari Kadri Veseli, kryeministri Isa Mustafa, presidenti i sapo zgjedhur Hashim Thaçi, ministri i FSK-së, Haki Demolli, vëllai i heroit Adem Jashari, Rifat Jashari, ministra të Qeverisë së vendit, ambasadorë, atashe, si dhe përfaqësues institucional dhe shtetëror e mysafirë të tjerë. Për nderë të shënimit të 18-vjetorit të rënies së Komandantit legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari si edhe të gjithë të rënëve për liri dhe pavarësi, para kuadrateve të rreshtuara parakaluan presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga dhe komandanti i Forcës së Sigurisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Pas intonimit të himnit shtetëror dhe kombëtar, udhëheqja me e lartë e shtetit; presidentja Atifete Jahjaga, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Isa Mustafa, ministri i FSK-së, Haki Demolli dhe komandanti i Forcë së Sigurisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama vendosën kurorë lulesh tek Obelisku i dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare dhe dëshmorëve të të gjithë brezave.

(vazhdon në faqen 4-5)



Ministri i Mbrojtjes së Kroacisë nderon dëshmorët në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kroacisë, Josip Buljeviç me bashkëpunëtorë, në ditën e dytë të qëndrimit në Kosovë, më 8 mars 2016, së bashku me ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), Haki Demolli vizituan Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Fillimisht, ministri Buljeviç vendosi kurorëlulesh mbi varrin e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, si dhe bëri homazhe në varrezat e familjes Jashari si dhe u shënua në Librin e kujtimeve në Muzeun historik në Prekaz.Ministrin Buljeviç në emër të familjes Jashari e priti Murat Jashari, nip i Komandantit legjendar Adem Jashari. Ai, me shumë vëmendje përcolli shpjegimet që i jepeshin për çdo të rënë nga Murat Jashari, cili e shoqëroi delegacionin nga Kroacia gjatë tërë kohës së qëndrimit të tij në Prekaz. Delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë vizitoi Kullat-Muze të Jasharajve dhe Muzeun Historik të Rezistencës së Jasharajve me në krye Komandantin legjendar Adem Jashari.Buljeviç, po ashtu, është pritur nga Murat Jashari në odën e familjes Jashari, i cili në emër të familjes i uroi mirëseardhje dhe e falënderoi për vizitën e tij në Kosovë dhe në familjen Jashari, duke vlerësuar lartë kontributin që ka dhënë dhe po jep Kroacia për Kosovën.Murat Jashari në emër të familjes shpjegoi historikun e qëndrimeve të familjes Jashari dhe bindjen e fortë që kishin, se pa luftë dhe sakrificë nuk vjen liria. Ministri Buljeviç për pritjen dhe respektin që ju bë nga familja Jashari shprehi falënderime të thella, duke shprehur njëherësh mirënjohje, nderim dhe respekt për qëndresën dhe sakrificën e madhe që është bërë nga familja Jashari me në krye Komandantin legjendar Adem Jashari.Ministri kroat me këtë rast foli për rezistencën çlirimtare të popullit kroat, sakrificat që ka bërë për liri, duke bërë krahasime me rezistencën e shqiptarëve për liri dhe ndërtimin e shtetit të lirë dhe të pavarur.



Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë vizitoi FSK-në

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë(FSK), z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama më 24 marskanë pritë në takime të ndara, shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjeneralmajor Jeronim Bazo me bashkëpunëtorë.Me këtë rast ministri Demolli e ka falënderuar gjeneralin Bazo dhe Shqipërinë për ndihmën e pakursyer që ata po japin në ngritjen profesionale të FSK-së, për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm ndërmjet dy institucioneve, si dhe për gatishmërinë e tyre për t'i ofruar ndihmë profesionale FSK-së, edhe në të ardhmen.Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama shprehu kënaqësinë e veçantë që e priti shefin e Shtabit të FA të Republikës së Shqipërisë, gjeneralin Bazo, për një vizitë pune e cila tregon për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm ndërmjet dy forcave tona. Të dy gjeneralët biseduan edhe për vazhdimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat e mundshme. Ministri Demolli dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama, me këtë rast e njoftuan shefin e Shtabit të FA të Republikës së Shqipërisë gjeneralin Bazo për të arriturat e deritashme të FSK-së si dhe për transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës."Ne kemi nevojë për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që edhe në të ardhmen të na ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve tona. Ne biseduam gjithashtu edhe për realizimin e projekteve të përbashkëta, sepse objektivi ynë është që Forcat e Armatosura të Kosovës të jenë edhe pjesë e familjes së NATO-s".Në fund, ministri Demolli dhe gjeneral Rama kanë falënderuar shefin e Shtabit të FA-së të Shqipërisë, gjeneralin Bazo, për gatishmërinë e tij dhe të Shtabit të FA të Shqipërisë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe afrimit të ndihmës profesionale për FSK-në.Ndërsa, shefi i Shtabit të FA të Republikës së Shqipërisë gjeneral Bazo pasi falënderoi ministrin Demolli dhe gjeneral Ramën për pritjen, ai shprehu gatishmërinë e FA të Republikës së Shqipërisë se edhe në të ardhmen do ta ndihmojnë FSK-në në të gjitha drejtimet.Në pritjen e delegacionit ushtarak të FA-së të Republikës së Shqipërisë morën pjesë gjeneralët: Zymer Halimi, Gëzim Hazrolli, kolonel Hysni Shabani dhe major Berat Shala. Ndërsa, delegacioni i Shqipërisë përbehej edhe nga kolonelët Ilir Pujo, Ilir Xhebexhia, nënkolonel Roland Shuli dhe kapiten Evis Tollja.



Gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në ndërrimin e komandantit të Forcave të Armatosura të Kroacisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, më 1 mars 2016, mori pjesë në ceremoninë kryesore me rastin e ndërrimit të Komandës së Forcave të Armatosura të Kroacisë, në Zagreb. Gjenerallejtënant Rrahman Rama ishte pjesë e ceremonisë në të cilën ishin edhe Presidentja e Republikës së Kroacisë, Kolinda Grabar Kitaroviq, kryetari i Kuvendit kroat, akademik Zheljko Rainer, ministri i Mbrojtjes Josip Buljevic si dhe shumë prej shefave të Shtabeve të Forcave të Armatosura të vendeve të rajonit e më gjerë.Në këtë aktivitetet solemn të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandantit të Forcave të Armatosura kroate. Komandën e Forcave të Armatosura e mori gjeneral kolonel Mirko Shundov, nga paraardhësi i tij, gjeneral Drago Lovric. Me këtë rast gjeneral Rama pati mundësinë të takoi personalitete të larta të fushës së Mbrojtjes të Kroacisë si dhe të vendeve pjesëmarrëse në aktivitetin e ndërrimit të Komandës së Forcave të Armatosura të Kroacisë në Zagreb.Ministria për Forcën e Sigurisë dhe Forca e Sigurisë së Kosovës kanë marrëdhënie të shkëlqyera me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kroacisë.



Drejtori i Zyres së Protokollit të MFSK-së, Gafur Dugolli lirohet pas arrestimit nga Republika e Maqedonisë

Më 11 mars 2016,ora 11:45, në pikën kufitare Bllacë të Republikës së Maqedonisë, nga policia e Maqedonisë është arrestuar Gafur Dugolli, drejtor i Zyrës së Protokollit të MFSK-së, i cili po shkonte me detyrë zyrtare për rregullim të vizës në Ambasadën e ShBA-së në Shkup. Arrestimi është bërë me urdhër të INTERPOL-it sipas kërkesës së Policisë së Serbisë, me akuzë se është i kërkuar për krime lufte, gjatë kohës kur zoti Dugolli ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Ky nuk është rasti i parë kur ish-ushtarët e UÇK-së, me akuza të fabrikuara dhe me kërkesë të policisë së Serbisë, ndalohen qytetarët e Kosovës, ish-luftëtarë të UÇK-së, nëpër kufijtë dhe aeroportet e shteteve të ndryshme. Tashmë pastërtia e luftës së UÇK-së është vërtetuar edhe nga gjykimet e stërzgjatura të Hagës. Me rastin e arrestimit të zotit Gafurr Dugolli organet shtetërore të Kosovës janë duke u marrë intensivisht, po ashtu kemi besim se edhe organet shtetërore të Maqedonisë do të kenë mirëkuptim dhe do ta lirojnë zotin Dugolli. Ndërsa,më datë 19 mars 2016, në orën 01:30 të mëngjesit, pas një jave arresti, është liruar Gafurr Dugolli, drejtor i Zyrës së Protokollit të MFSK-së.




FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Haki Demolli priti ministrin e Mbrojtjes së Kroacisë, Josip Buljeviç

(Vijon nga faqja e parë)

Ministri Buljeviç u angazhua për përkrahje edhe në fushat konkrete në të cilat Ministria e Mbrojtjes së Kroacisë mund ta mbështesë FSK-në, si trajnimin e forcave për operacione speciale, trajnimin e personelit në fushën e inteligjencës etj. Ministri Buljeviç u shpreh i gatshëm të mbështesë Republikën e Kosovës në qëllimin e saj, pra transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura si dhe premtoi mbështetje për hapjen e mundësive që Kosova të anëtarësohet në iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë. Në takim të pranishëm ishin edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministrat Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, ambasadorja e Kosovës në Zagreb, zonja Shkëndije Geci, sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj, drejtori i Inspektoratit, gjeneral brigade Bashkim Jashari, shefi i Departamentit për Bashkëpunim, Siguri dhe Marrëdhënie me Jashtë, kolonel Ilir Qeriqi, këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Fadil Hadergjonaj. Nga pala kroate, pos ministrit Buljeviç në vizitë ishin edhe ambasadorja e Kroacisë në Kosovë, Marija Kapitanoviq, këshilltari për çështje të veteranëve i presidentes kroate, Ante Deur, Nikola Berzica, asistent për Politika të Mbrojtjes i ministrit, Goran Grosniç, shef i Kabinetit, Zoran Drça, ndërlidhës i Kabinetit të ministrit, Nikica Kopaçeviç, këshilltar i lartë i ministrit, kolonel Ivica Mateshiq, atashe i Mbrojtjes i Republikës së Kroacisë për Kosovë dhe Maqedoni, Jelena Vresh, këshilltar i ministrit. Pas takimit, të dy ministrat Demolli dhe Buljeviç dhanë nga një deklaratë për media si dhe u përgjigjen në pyetjet e gazetarëve. Në fund ministri Demolli dhe delegacioni kroat në krye me ministrin Buljeviç vazhduan vizitën në Qendrën për Studime Universitare(QSU) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), për të parë nga afër kushtet dhe nivelin e përgatitjes që kjo qendër ofron për oficerët e ardhëm të FSK-së. Në QSU, delegacioni kroat u pritë nga gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Komandë së Forcave Tokësore, ndërsa komandanti i Qendrës, major Avni Kiqina bëri



një prezantim të shkurtër për misionin, punën, aktivitetet dhe sukseset e QSU-së që nga themelimi e deri më tani. Kjo është vizita e parë e ministrit të Mbrojtjes së Kroacisë, Josip Buljeviç në vendin tonë, prej që Ai ka marr detyrën e ministrit. Vlen të theksohet se Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes së Kroacisë kanë marrëdhënie shumë të mira dhe se këto marrëdhënie janë zyrtarizuar edhe me memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive.

Ligjeratë e Komandanti të FSK-së, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës

Forca e Sigurisë së Kosovës e gatshme për transformim në Forca të Armatosura

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama,më 22 marsmbajti një ligjëratë për studentët e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, me temë:,,Transformimi i Forcës së Sigurisë në Forca të Armatosura të Kosovës". Fillimisht, këtë aktivitet me një fjalë mirëseardhjeje e hapi dekani i Fakultetit Filozofik, Bujar Dugolli i cili shprehu kënaqësinë që komandanti i FSK-së, do të flasë para studentëve të të gjitha degëve të Fakultetit Filozofik mbi temën e sigurisë si dhe transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur, temë kjo për të cilën studentët e këtij fakulteti kanë nevojë të jenë të informuar ashtu si edhe për fusha tjera të institucioneve të shtetit. Me këtë rast, gjenerallejtënant Rrahman Rama para profesorëve dhe studentëve të këtij fakulteti, fillimisht, theksoi aspiratën e shtetit të Kosovës për anëtarësim në NATO si dhe kronologjinë e ngritjes së sektorit të sigurisë në funksion të realizimit të qëllimit të Republikës së Kosovës që një ditë të jetë anëtare me të drejta të plota në Aleancën Veri-Atlantike. Pastaj, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama foli shkurtimisht edhe mbi historikun e institucionit të sigurisë, që nga transformimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës(UÇK) në Trupat e Mbrojtjes të Kosovës(TMK), pastaj për ngritjen dhe zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke qenë



se edhe personalisht ka qenë në stafin udhëheqës të këtyre institucioneve.Komandanti i FSK-së i njoftoi studentët mbi misionin, strukturën, pajisjet dhe aktivitetet e Forcës së Sigurisë, pastaj trajnimet, shkollimet stërvitjet si dhe mbi marrëdhëniet dypalëshe që Forca e Sigurisë së Kosovë ka me partnerët strategjikë dhe vendet anëtare të NATO-s, e gjithashtu me marrëdhëniet me ministritë e Mbrojtës dhe Forcat e Armatosura të vendeve fqinje në rajon. Gjenerali tha se FSK-ja është ngritur dhe zhvilluar mbi bazën e standardeve të NATO-s dhe synon të jetë kompatibile dhe e ndërveprueshme me të gjitha ushtritë e vendeve NATO-s.Gjithashtu, gjeneral Rama foli edhe mbi procesin tanimë të përfunduar në nivel të shtetit, pra për procesin e Rishikimit të Strategjisë të Sektorit të Sigurisë së Kosovës(RSSSK) si dhe i njoftoi të pranishmit për rekomandimet e dala nga RSSS për Ministrinë dhe Forcën e Sigurisë, në bazë të të cilave theksoi komandanti i FSK-së, ministria dhe FSK-ja kanë bërë përgatitjet e duhura për një transformimin sa më të suksesshëm atëherë kur institucionet më të larta të shtetit vendosin që FSK-ja të transformohet në Forca të Armatosura.Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama para studentëve paraqiti edhe planin e përgatitur nga Ministria dhe FSK-ja për zhvillimin e kapaciteteve të Forcës së ardhme të Armatosur. Ndër tjera Ai foli për misionin, strukturën, pajisjet, buxhetin si dhe fazat e ngritjes së kapaciteteve operacionale të FAK, gatishmërinë për fillimin e zbatimit të këtij plani në momentin që merret vendimi politik.Gjeneral Rama u shpreh i përkushtuar për përmbushjen e misionit të FSK-së me sukses dhe fillimin e implementimit të misionit të Forcës së ardhshme, një Forcë e ngritur në të mirë dhe në shërbim të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës si dhe një Force për të mirë në rajon e me gjerë.Në fund gjeneral Rama u përgjigj në pyetje të shumta që audienca i drejtoj atij, e që kishin të bën kryesisht me rekrutimin, pajisjet si dhe fushëveprimin e FSK-së në përgjithësi.Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në disa raste ka ndarë kohën për t'iu përgjigjur kërkesave të universiteteve, kolegjeve e institucioneve tjera me qëllim njoftimin e studentëve për fushën e sigurisë në vendin tonë, dhe këtë praktikë do ta vazhdojë sa herë që do t'i kërkohet në të ardhmen.

Pjesëmarrësit e FSK-së gjatë trajnimit në Gjermani vizituan Ambasadën e Kosovës në Berlin

Gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, shef i Departamentit për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK) dhe një delegacion i gjerë nga Ministria u pritën në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Republikën Federale të Gjermanisë, nga atasheu i FSK-së në Gjermani, kolonel Xhavit Sadrija, si dhe zëvendës ambasadori Astrit Zemaj.Delegacioni i MFSK shoqërohej nga gjeneral brigade Michael Matz, komandant për çështje të përgjithshme territoriale të Forcave të Armatosura të Gjermanisë (Bundeswehrit), si dhe stafi udhëheqës i Qendrës për Udhëheqje të Brendshme Kapitenfregate Dirk Peddinghaus-udhëheqës i Qendrës dhe nënkoloneli Martin Gerster-udhëheqës i trajnimit. Fillimisht zëvendës ambasadori Zemaj për të pranishmit bëri një prezantim të shkurtër gjithëpërfshirës lidhur me misionin diplomatik të Republikës së Kosovës në Gjermani.Ndërsa, koloneli Sadrijaj përshëndeti të gjithë të pranishmit, në veçanti ai falënderoi udhëheqësit e trajnimit të cilët i mundësuan delegacionit njohjen me detyrat dhe përgjegjësitë e atasheut të FSK-së, me rolin dhe pozitën e tij në misionin diplomatik të Republikës së Kosovës në Republikën Federale të Gjermanisë.Kolonel Sadrijaj bëri një prezantim të shkurtër të disa nga të arriturat e tij që nga fillimi i shërbimit si: koordinimi në realizimin e trajnimeve të një numri të madh të pjesëtarëve të MFSK/FSK në specializime dhe afate kohore të ndryshme pothuaj në të gjitha qendrat ushtarake të Bundeswehrit, hapja e mundësive të reja për trajnime në të gjitha nivelet, pastaj fillimi i shkollimit të kadetëve të rinj të



FSK-së në Akademitë Ushtarake të Bundeswehrit. Kontributi i Bundeswehrit në zhvillimin e FSK-së është mjaft i madh dhe për këtë jemi shumë mirënjohës. Si çdo shërbim tjetër edhe ky i yni përveç arritjeve ka edhe sfidat e veta, u shpreh koloneli."Është një mision i ri me një status atashe i FSK-se në mesin e gati 150 atasheve të Mbrojtjes ku depërtimi tek informacionet por dhe bashkëpunimi është i vështirësuar, por oficerët nuk dorëzohen, ata gjejnë mundësitë për të fituar betejat"- tha koloneli. Gjenerali Brahimaj e përgëzoi atasheun Sadrijaj për prezantimin e kompletuar duke i premtuar mbështetje të vazhdueshme nga MFSK-ja. Gjenerali Brahimaj gjithashtu tha se është një ndjenjë e posaçme kur gjendesh në një Ambasadë si kjo me një staf kaq profesional, që me vite kemi ëndërruar ta kemi, prandaj ju përgëzoj të gjithëve për punën që po bëni në përfaqësimin e Republikës së Kosovës në një shtet mik dhe të rëndësishëm siç është Gjermania për Kosovën.Edhe gjenerali Matz, falënderoj kolonelin Sadrijaj për prezantimin e tij profesional, duke i premtuar edhe në emër të Bundeswehrit angazhimin që atasheu i FSK-së të ketë statusin e vërtetë, në kuadër të korit të atasheve në Berlin. Delegacion i MFSK është duke ndjekur në Berlin një trajnim specialistik një javor me temën Forcat e Armatosura në Demokraci, të organizuar nga Qendra për Udhëheqje të Brendshme e Bundeswehrit në Strausberg. Trajnimi zhvillohet në kuadër të programit të bashkëpunimit dypalësh vjetor në mes MFSK-së dhe Ministrisë Federale të Mbrojtjes së Gjermanisë.

Në FSK u mbajt manifestimi qendror 'Epopeja e UÇK-së'

Manifestimi qendror në kuadër të shënimit të "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", nën patronatin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, u mbajt në kazermën ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Prishtinë.Në ceremoninë e sotme në FSK, ishin të pranishëm: Presidentja Atifete Jahjaga, krye-parlamentari Kadri Veseli, kryeministri Isa Mustafa, presidenti i sapo zgjedhur Hashim Thaçi, ministri i FSK-së, Haki Demolli, vëllai i heroit Adem Jashari, Rifat Jashari, ministra të Qeverisë së vendit, ambasadorë, atashe, si dhe përfaqësues institucional dhe shtetëror e mysafirë të tjerë.Për nderë të shënimit të 18-vjetorit të rënies së Komandantit legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari si edhe të gjithë të rënëve për liri dhe pavarësi, para kuadrateve të rreshtuara parakaluan presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga dhe komandanti i Forcës së Sigurisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Pas intonimit të himnit shtetëror dhe kombëtar, udhëheqja me e lartë e shtetit; presidentja Atifete Jahjaga, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Isa Mustafa, ministri i FSK-së, Haki Demolli dhe komandanti i Forcë së Sigurisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama vendosën kurorë lulesh tek Obelisku i dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare dhe dëshmorëve të të gjithë brezave.Me këtë rast, kryetarja e shtetit, zonja Jahjaga duke









gjatë e të rëndë; një liri për të cilën është sakrifikuar; një miqësi e përjetshme me ShBA-në që ka qëndruar kaq pranë nesh në secilin kapitull të shtet-ndërtimit tonë. Kosova është vlera e shtuar e stabilitetit dhe sigurisë jo vetëm në rajon, një forcë e pazëvendësueshme e fqinjësisë, garantuese e paqes për të gjithë, që hap rrugën e integrimeve".Në fund të fjalës së saj presidentja Jahjaga tha: ,,Sot është festë për ju pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që keni përmbledhur me sukses prej shumë muajsh punën tuaj në ndërtimin e një force të re mbrojtëse e që po prisni, ashtu si edhe të gjithë qytetarët e tjerë, ta realizoni ëndrrën tuaj. Forca e Armatosur e Kosovës është e ardhmja e juaj, e ardhmja jonë e përbashkët, e ardhmja e shtetit të Kosovës!" .Në nderim të Epopesë së UÇK-së, në Manifestim për nderë të 18 vjetorit të rënies së Komandantit legjendar Adem Jashari, me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama i cili para kuadrateve dhe forcave që Ai drejton, si dhe para udhëheqësve institucionalë e shtetërorë mbajti një fjalë rasti.Gjeneral Rama ndër të tjera tha : ,,Një komb që nuk di të vlerësojë të kaluarën, ai nuk mund të ketë as të ardhme të sigurt". Ne, shtoi gjeneral Rama duhet të ndërtojmë identitetin dhe vlerat tona, që dalin nga historia e lavdishme e popullit tonë".Më tej gjeneral Rama shtoi:,,Duke mësuar nga e kaluara dhe duke mësuar nga shembujt e botës demokratike, të ndjekim traditën, "Nderojmë të kaluarën dhe ndërtojmë të ardhmen". Me këtë moto, tha komandanti i FSK-së, Forca e Sigurisë së Kosovës është duke punuar që të ndërtojë një forcë profesionale, në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj. Kjo Forcë,,do të ndërtohet mbi vlerat tona kombëtare, dhe vlerat euroatlantike e perëndimore. Kjo forcë do të jetë e ndërvepruesshme me gjithë partnerët tanë, dhe e gatshme që t'iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të



Ministri dhe komandanti i FSK-së bënëhomazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz



Në kuadër tëshënimit të18 vjetorit të Epopesë së UÇK-së dhe në nderim të Komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit, më 6 mars 2016,një delegacion i MFSK-së dhe FSK-së vizitoi Prekazin dhe familjen Jashari. Ministri Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me stafin e lartë të Ministrisë dhe FSK-së, në Kompleksin Memorial ,,Adem Jashari" në Prekaz, në shenjë nderimi vendosën kurora me lule të freskëta, bënë homazhe dhe vizituan familjen Jashari.Delegacioni i FSK-së u prit edhe në kullën e familjes Jashari nga Rifat Jashari dhe pjesëtarë tjerë të kësaj familje. Me këtë rast ministri Demolli në emër të delegacionit të FSK-së, çmoj lartë sakrificën e pashembullt të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit. Gjithashtu ministri Demolli falënderoi vëllain e Komandantit legjendar, Rifat Jasharin për pritjen dhe njëherësh i shprehu krenarinë dhe respektin që ka FSK-ja për familjen Jashari.Ndërsa Rifat Jashari falënderoi Ministrin Demolli dhe të gjithë stafin e lartë të FSK-së, Ai po ashtu përgëzoi FSK-në për arritjet e përgjithshme.

Ministri dhe komandanti i FSK-së nderuan dëshmorët e UÇK-së në 'Epopenë e Dukagjinit'



Në kuadër të manifestimit "Epopeja e Dukagjinit", më 24 mars 2016, ministri i FSK-së Haki Demolli, zëvendësministër Fadil Gashi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku edhe me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë z. Qemal Minxhozi, të shoqëruar edhe nga gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli si dhe oficerë të tjerë të lartë të FSK-së, bënë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Gllogjan, duke vendosur buqeta me lule, në nderim të dëshmorëve të rënë në luftën çlirimtare të UÇK-së. Delegacioni i FSK-së me në krye ministrin Demolli, pas homazheve bënë vizitë në familjen Haradinaj, ku u pritën ngrohtësisht nga kryefamiljari Hilmi Haradinaj. Me këtë rast ministri Demolli shprehu mirënjohjen dhe respektin e thellë për sakrificën e madhe të familjes Haradinaj, të luftëtarëve të Dukagjinit dhe gjithë dëshmorëve të UÇK-së. Ai shprehu besimin e thellë se Kosova dhe populli i saj do të jenë gjithmonë mirënjohës për sakrificën e bërë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Kosovës".Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, para të pranishmëve tha gjithashtu se ,,është në duart tona, që me përkushtim të avancojmë drejt ndërtimit të vendit, institucioneve, dhe që të jemi zot të këtij vendi, duke ndërtuar perspektivë për gjeneratat e reja".Në fund, gjeneral Rama tha: ,,Është në duar tona që amanetin e të rënëve të shtyjmë përpara me përkushtim, se vetëm kështu nderojmë gjakun e derdhur dhe nderojmë të rënët me gjenerata të tëra", duke thirrur për lavdi siç tha Ai, ,,Lavdi Familjes Jashari; Komandantit legjendar Adem Jashari; dëshmorëve të UÇK-së dhe gjithë dëshmorëve të kombit.Manifestimin e nderoi edhe përfaqësuesi i familjes Jashari, vëllai i Komandantit legjendar Adem Jashari, zotëri Rifat Jashari i cili ndër të tjera u shpreh se: ,,duhet të jemi syçelë në mënyrë që ta ruajmë gjakun e bijve dhe bijave tona, ta qojmë përpara amanetin për të cilin ranë dëshmorët e kombit të të gjithë brezave. Në fund, Rifat Jashari thirri për unitet në mënyrë që siç tha Ai çdo sfidë do ta kalojmë më me lehtësi.Në fund të ceremonisë Bendi muzikor i FSK-së ekzekutoi disa melodi instrumentale me motive nga tradita, rezistenca dhe kultura e vendit tonë.



Me rastin e 8 marsit Ministri Demolli uroi gratë që punojnë në Ministri dhe FSK



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ministri Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama si dhe sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, pritën në një koktej rasti gratë ushtarake dhe civile që shërbejnë në MFSK dhe FSK. Ministri Demolli me këtë rast ka përgëzuar të gjitha gratë që shërbejnë në Ministri dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës, për punën e tyre profesionale dhe për arritjet në kuadër të Ministrisë dhe FSK-së. Ai, tha: "Dita Ndërkombëtare e Gruas paraqet një mundësi për të festuar arritjet e grave, prandaj, unë ju përcjell urimet e mia më të mira për ju dhe ju falënderoj për shërbimin tuaj të veçantë, kontributin dhe përpjekjet e bëra në zhvillimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës". Gjithashtu 8 Marsin, grave ushtarake dhe civile që shërbejnë në Ministri dhe FSK, ua uruan edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe sekretari Shkëlzen Sylaj. Gjeneral Rama tha se ju me punën tuaj profesionale po kontribuoni shumë në ngritjen e imazhit të FSK-së, si brenda ashtu edhe jashtë shtetit.Në emër të grave të MFSK-së dhe FSK-së, znj. Halimi Morina, shefe e Drejtave të Njeriut në Ministrinë e FSK-së, falënderoi ministrin, komandantin dhe sekretarin për pjesëmarrjen e tyre në këtë koktej rasti.Ndërkaq, ministri, komandanti dhe sekretari, në emër të Ministrisë dhe FSK-së iu dhuruan të gjitha grave nga një lule në shenjë nderimi dhe respekti. 8 Marsi u shënua edhe në Komandën e Forcave Tokësore të FSK-së si dhe në të gjitha njësitë vartëse, në të gjitha kazermat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si në Brigadën e Reagimit të Shpejtë dhe në të tri batalionet e saj, pastaj në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Brigadën për Mbështetje Operacionale dhe njësitë e saj. Me këtë rast zv.komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli i përgëzoi të gjitha oficeret, nënoficeret dhe ushtaret e FSK-së për punën e palodhshme që po e bëjnë në shërbim të FSK-së. Gjeneral Hazrolli dhe stafi i tij, duke iu dhuruar lule me rastin e kësaj dite, ju dëshiruan të gjitha ushtarakeve dhe shërbyeseve civile shëndet e mbarësi në punë, familje dhe në jetë.

Drejtori i NLAT-it gjenerali Ernst Horn vizitoi Brigadën për Reagimit të Shpejtë në Istog



Komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSh), kolonel Xhevahir Geci ka pritur në një vizitë drejtorin e Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për Forcën së Sigurisë(NLAT), gjeneral brigade Ernst Horn, i cili ka qenë i shoqëruar nga nënkolonel Boeceker, asistent ushtarak dhe nga këshilltarët e NLAT-it për BRSh-në, nënkolonel Poulsen dhe nënkolonel Kreutz.Fillimisht, kolonel Geci pati një takim me gjeneralin Horn, të cilin e njoftoi me aktivitetet e BRSh-së.Pastaj, shefi i Shtabit të BRSh-së, major Ejup Maqedonci, përmes një prezantimi bëri një pasqyrim të detajuar për misionin e BRSh-së, strukturën, lokacionet, trajnimet/aktivitetet, gjendjen e gatishmërisë, planifikimin si dhe sfidat.Gjatë qëndrimit në BRSh, gjeneral brigade Horn vizitoi edhe aktivitete të cilat kanë qenë duke u realizuar në bazë të planit të aktiviteteve të BRSh-së si: realizimin e trajnimit "Taktika me njësi të vogla", që ka filluar nga data 08.03.2016 dhe do të zgjasë 5 javë, ku po marrin pjesë 39 pjesëtarë.Gjithashtu, Ai pati mundësi t'i ndjek nga afër disa demonstrime të aktiviteteve nga pjesëtarët e Batalionit të Dytë të BRSh-së, si; Prezantimi i Urdhrit Operacional (maketës-koncepti i operacionit), dhe realizimi në praktikë i reagimit në kontakt.Pas përfundimit të vizitës në Komandën e BRSh-së, gjenerali Horn, sipas agjendës vizitoi edhe Batalionin e Dytë të BRSh-së, ku u prit nga komandanti i Batalionit, nënkolonel Mehmet Lladrovci me stafin e tij, të cilët e njoftuan për realizimin e aktiviteteve në këtë njësi.Në fund, gjeneral brigade Horn falënderoi kolonelin Xhevahir Geci për pritjen e organizuar dhe për informimin që i është bërë mbi të arriturat e FSK-së, përkatësisht të BRSh-së, duke i përgëzuar njëherësh edhe për arritjet e tyre.Gjatë qëndrimit në kazermën e BRSh-së në Istog, gjeneral brigade Horn u nda i kënaqur me të arriturat në FSK, gjegjësisht në BRSh dhe të dy se bashku; kolonel Geci dhe gjeneralI Horn u dakorduan për një angazhim edhe më të madh në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet FSK-së (BRSh) dhe NLAT-it.

FSK-ja në operacion për kërkimine fëmijës së humbur në lumin Klina



Më 9 mars 2016, rreth orës 21:30 një ekip i kërkim-shpëtimit të Task Forcës së Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), ka marrë pjesë në operacionin e kërkim-shpëtimit në lumin Klina në Skenderaj, ku dyshohej se kishte rënë një fëmijë. Ekipi i kërkim-shpëtimit të FSK-së së bashku me Policinë e Kosovës dhe në mbështetje të pushtetit lokal kanë filluar kërkimin e fëmijës së humbur. Pasi që kushtet atmosferike kanë qenë shumë të vështira, ka pasur valë të mëdha dhe të rrëmbyeshme, njësiti i kërkim-shpëtimit ka vendosur dy rrjeta, afër urave, në lumin Klina. Operacioni i njësisë së FSK-së, ka përfunduar pas tri orë kërkimesh me gjetjen e trupit të pajetë të fëmijës. Në këtë operacion të kërkim-shpëtimit janë angazhuar 9 pjesëtarë të Task-Forcës të FSK-së, me tri automjete dhe pajisje tjera specialistike për kërkim-shpëtim.

Komandanti i FSK-së gjeneral Rama vlerësoi lartë angazhimin e pjesëtarëve të komuniteteve në FSK



Më 29 mars në Kazermën e Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) "New Born" në Gjilan, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama ka mbajtur takim me pjesëtarë të komuniteteve të cilët shërbejnë në radhët e Brigadës për Reagim të Shpejtë.Në këtë takim të pranishëm ishin edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, atasheu amerikan i Mbrojtjes në Kosovë kolonel Chud Butts, komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci dhe komandantët e Batalionit të Parë, Dytë dhe Tretë të BRSH-së, nënkolonelët Haki Xhemajli, Mehmet Lladrovci dhe Beton Retkoceri.Para lidershipit të FSK-së dhe të gjithë të pranishmëve, komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, mbajti një Brifing informues rreth përfshirjes së pjesëtarëve të komuniteteve në Brigadën e Reagimit të Shpejtë, pjesëmarrjen e tyre në trajnime dhe ngritjen profesionale të tyre si brenda dhe jashtë vendit, avancimet e pjesëtarëve të komuniteteve në BRSH, sfidat dhe problemet e mundshme të komuniteteve, si dhe rëndësinë e tyre për të ardhmen e FSK-së.Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama foli në përgjithësi për rolin e minoriteteve në FSK, për mënyrën e gradimeve, pozicionimin dhe radhitjen e tyre në FSK, duke u shprehur shumë i kënaqur me punën dhe kontributin e tyre. Ai po ashtu kërkoi nga ta angazhim sa më të madh në investimin e të ardhmes së tyre.Pjesëtarët e FSK-së, të pranishëm në takim, patën mundësinë që të bëjnë pyetje të ndryshme të cilave iu është përgjigjur komandanti i FSK-së gjeneral Rama së bashku me eprorët e tjerë të pranishëm.Ndërsa për integrimin e pjesëtarëve të minoriteteve në FSK dhe problemet e tyre foli edhe koloneli amerikan Chud Butts, i cili ndër të tjera u shpreh: "Duhet të punoni të gjithë së bashku për të arritur qëllimin e caktuar të FSK-së. Problemet të cilat ju jeni duke i kaluar janë të njëjta me problemet e të gjithë pjesëtarëve të FSK-së. Ky hap është shumë i rëndësishëm për integrimin edhe më tutje të minoriteteve në FSK".Të kënaqur me punën dhe trajtimin e tyre u shprehën edhe pjesëtarët e minoriteteve të pranishëm, të cilët thanë se ndihen të barabartë me të gjithë pjesëtarët e FSK-së, pa dallime racore apo fetare.



Këshilltari për mjekësi i NLAT-it vizitoi kazermën e FSK-së "Ushtarët e NATO-s"

Në kazermën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), "Ushtarët e NATO-s", në Istog, më 15 mars 2016, për një vizitë pune qëndroi një ekip i lartë i këshilltarëve nga Ekipi Ndërlidhës Këshillues i NATO-s për FSK-në (NLAT), të udhëhequr nga shefi i degës së ekspertëve, kolonel Dr. Michael Romba, këshilltari për mjekësi kolonel Matti Lehesjoki si dhe drejtori i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës kolonel Dr. Xhevdet Tahiraj.Ekip i këshilltarëve të NLAT-it u pritë nga komandanti i Batalionit të Dytë të BRSH-së, nënkolonel Mehmet Lladrovci me stafin e tij, dhe nga stafi i Sektorit të Mjekësisë në kuadër të Batalionin të Dytë.Ekipin këshillues të NLAT-it për kapacitetet e mjekësisë të BRSH-së, i njoftoi nënkolonel Mehmet Lladrovci. Gjatë takimit biseduan për fushat e trajnimit, si dhe identifikimin e fushave të nevojshme për trajnime shtesë. Pas takimit ekipi vizitoi Sektorit të Mjekësisë, ku këshilltarët e NLAT-it u njohën me punën dhe sfidat që ka ky sektor. Në fund, të dy palët u pajtuan për fushat e trajnimit dhe fillimin e konkretizimit të tyre në praktikë.

FSK-ja e para në garën "Ushtari më i mirë" mbajtur nga KFOR-i Amerikan në Kampin Bondsteel

Në organizimin e KFOR-it amerikan nga data 11-13 shkurt 2016, në kampin Bondsteel dhe në ambientet e kazermës "Skënderbeu" në Ferizaj, u mbajtën garat për zgjedhjen e ushtarëve më të mirë, në të cilën garë morën pjesë 10 ekipe të ushtrive të shteteve të NATO-s që janë në Kosovë, si nga Amerika, Gjermania, Polonia, Hungaria dhe Kosova. Garat u mbajtën në pesë disiplina si: Gjuajtje me armë të shkurtra dhe të gjata; kursi i pengesave-kalitje fizike; marshim rrugor 10 km me 16 kg ngarkese; montim dhe çmontim i armëve dhe ndihmë e parë.Në këtë garë morën pjesë edhe dy ekipe të FSK-së (me nga dy pjesëtarë) nga Batalioni i parë i Brigadës për Reagim të Shpejtë në Gjilan. Ekipi i parë përbëhej nga tetar Rafet Gashi dhe ushtar Liridon Selimi, ndërsa në ekipin e dytë bënin pjesë; tetari Alban Azemi dhe ushtari Muhamet Hafizi. Të dy ekipet e FSK-së, treguan rezultate të shkëlqyeshme gjatë garës për zgjedhjen e ushtarit më të mirë. Në mesin e dhjetë ekipeve garuese vendin e parë e zuri ekipi i parë i FSK-së, duke dalë më i miri në të gjitha disiplinat. "Duke marrë parasysh nivelin dhe konkurrencën e lartë në këto gara, kjo është një e arritur mjaft e lartë jo vetëm për pjesëtarët që garuan, por edhe për vetë FSK-në dhe Kosovën në përgjithësi, pasi me këtë tregon që pjesëtarët tanë kanë një përgatitje të lartë arsimore dhe fizike, të nivelit me shtetet e rajonit dhe ato evropiane" shton i lumtur Rafet Gashi i cili zuri vendin e parë së bashku me ushtarin Liridon Selimin. Rafeti, në një prononcim për gazetën "Forca Jonë" të FSK-së, është shprehur mjaft i lumtur që ka zënë vendin e parë, sepse mendon se kështu e përfaqëson më së miri nivelin e FSK-së, dhe sukseset e saj. Tetar Rafet Gashi ka marrë pjesë në shumë gara të organizuara në Kosovë, ku gjithmonë ka qenë ndër më të mirët. Rafeti ishte fitues i Krosit të mbajtur vitin e kaluar (2015), organizuar për nder të Ditës së Forcës, pjesëmarrës në garën "Ushtari më i mirë", në trajnimin "Ujku garues" si dhe dy herë pjesëmarrës në marshimin kondicional në Nijemigen në Holandë. Ai, pos tjerash, tha:„tani, për mua, garat veç se janë bërë pjesë e pandashme e punës dhe karrierës sime ushtarake, pasi që kjo nuk është hera e parë që marrë pjesë në gara sfiduese, mirëpo kjo garë ka rëndësinë e vetë dukë marrë parasysh që të gjithë garuesit ishin të një niveli mjaft të lartë dhe jam mjaft i kënaqur që duke përfaqësuar FSK-në të arrijmë të fitojmë vendin e parë".Ndërsa ushtari Liridon Selimi pjesëtar i Togut ceremonial të FSK-së, i cili në garën "Ujku garues" kishte zënë vendin e dytë, ishte i kënaqur që zuri vendin e parë, në këtë garë ku morën pjesë ushtarët e shteteve të shumta që veprojnë në kuadër të KFOR-it në Kosovë. „Bashkë me tetar Rafet Gashin kemi qenë një ekip mjaft i mirë, duke marrë parasysh që gara ishte shumë e vështirë, ne si ekip kemi arrit që të gjitha vështirësitë t'i kalojmë së bashku" i cili suksesin ia dedikoi FSK-së. Ushtar Selimi është i kënaqur edhe me atë se, siç thotë:„kemi krijuar miqësi të mirë me të gjithë pjesëmarrësit dhe me këtë garë kemi treguar kulturën dhe përgatitjet që kanë pjesëtarët e FSK-së, si në aspektin arsimor, fizik e që jemi në hap me shtetet tjera të



Evropës. Unë ndihem mjaft i lumtur që zumë vendin e parë dhe që e përfaqësuam denjësisht institucionin tonë, pra FSK-në".Gjithashtu Liridoni dhe tetar Alban Azemi (pjesëtar i ekipit të dytë) ishin më të mirët në gjuajtje me armë të shkurtra dhe të gjata, me çka morën mirënjohje të veçanta të cilësuar si "Ekspertë të Gjuajtjes".Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë Gjeneral Ben Hodges, pas përfundimit të këtyre garave, në shenjë respekti për ekipin fitues, ka organizuar një udhëtim me helikopter për dy pjesëtarët e FSK-së, nga FILM CITY në Bondsteel dhe anasjelltas.Pjesëtarët e FSK-së, kudo që po e përfaqësojnë Republikën e Kosovës qoftë brenda apo jashtë saj, po dallohen me paraqitje të shkëlqyeshme si në gara individuale dhe ekipore. FSK-ja është në rrugë të mbarë për arritjen e të gjitha standardeve të NATO-s.

Të rinjtë e OJQ-së „Play International" qëndruan në kazermën „Skënderbeu" të FSK-së në Ferizaj



Në Kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Ferizaj, për dy ditë, nga data 19-20 mars 2016, qëndruan 47 të rinj të Organizatës Joqeveritare(OJQ) "Play International". Projekt i OJQ-së „Play International" u realizua në koordinim me Departamentin e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak(BCU) në Ministrinë e FSK-së dhe KDS-në.Drejtori i BCU-së, Hajrush Kurtaj së bashku me stafin e tij kanë qenë pjesë e këtij bashkëpunimi ku janë realizuar një sërë aktivitetesh nga OJQ-ja "Play 4 Youth". Ndërsa Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes u ka afruar hapësirat si: klasë mësimi, fushat e sportit dhe hapësirat tjera sportive, akomodimin dhe mbështetjen logjistike për ta, kurse programi ka qenë i harmonizuar dhe përshtatur për ambientin e kazermës nga vet përfaqësuesit e kësaj organizate. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka realizuar projekte të tilla edhe më parë në mbështetje të OJQ-ve, por edhe të institucioneve edukative- arsimore të Kosovës.Valentina Pancaldi menaxhere e këtij projekti shprehu mirënjohje dhe njëherësh falënderoi FSK-në për tërë atë që ka bërë dhe po bëjnë jo vetëm për këtë organizatë dhe të rijntë tjerë të Kosovës. „Jemi të befasuar me pritjen dhe organizimin që bënë për ne" u shpreh znj. Pancaldi.Ndërsa, në emër të KDS-së, të rinjtë i përshëndeti kapiten Fatlum Demiri i cili u tha:"Ekipi im nuk e kishte të vështirë të punojë me ju, për shkak se ju ishit bashkëpunues dhe më vjen mirë që projekti u realizua ashtu siç edhe ishte i planifikuar".Vlen të theksohet se pjesë e këtij aktiviteti kanë qenë të rinjtë vullnetarë nga të gjitha etnitë të cilët kanë punuar në grupe.

Përurohet objekti për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të FSK-së

Në kazermën "Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë u mbajt ceremonia e përurimit të Anex Servisit të automjeteve të Brigadës së Mbështetjes Operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës.Në këtë ceremoni të pranishëm ishin zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK(NLAT), gjeneral brigade Ernest Horn, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSh), kolonel Xhevahir Geci, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale(BMO), kolonel Muharrem Rrahmani si dhe eprorë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it.Me këtë rast, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli fillimisht falënderoi të gjithë të pranishmit dhe njëherësh u shpreh i kënaqur me realizimin e këtij projekti mjaft të rëndësishëm për FSK-në. Ai tha:„Që nga viti 2011 janë realizuar gjithsej 23 projekte dhe secili prej tyre ka rëndësi të veçantë në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, në afrimin e kushteve të punës dhe infrastrukturës së përgjithshme, sidomos depove të armatimit dhe municionit, sallave sportive, terreneve sportive dhe shumë projekte tjera që janë realizuar nga fondi i mirëbesimit, por ju garantoj që ky projekt është me rëndësi të veçantë dhe jam shumë i sigurt që do ta përdorim në formën më të mirë në ngritjen e nivelit të mirëmbajtjes së FSK-së". Një falënderim të veçantë gjeneral Hazrolli pati për të gjithë ata, që mundësuan realizimin e këtij projekt." Falënderoj në veçanti ata që mundësuan realizimin e këtij projekti, jam shumë i sigurt që ky është në vazhdën e projekteve tjera të rëndësishme nga fondi i mirëbesimit, dhe dua të shfrytëzoj nga rasti në emër të komandantit të FSK-së, oficerëve dhe nënoficerëve të gjitha qeveritë e shteteve anëtarë dhe taksapaguesit e atyre shteteve për mundësinë e ngritjes së këtij fondi dhe ndihmesën që i bëjnë FSK-së".Ndërsa drejtori i NLAT-it gjeneral brigade Ernest Horn u shpreh i lumtur që është pjesë e kësaj ceremonie." Është kënaqësi për mua të jem i pranishëm në prerjen e shiritit dhe



përurimin e këtij objekti, një hap mjaft i rëndësishëm përpara në aftësitë për të kryer këto shërbime rreth mirëmbajtjes së automjeteve dhe pajisjeve".Ky projekt ka filluar së realizuari në vitin 2014, është realizuar nga Donacioni i Fondit të Mirëbesimit ku shuma e tij arrin vlerën e 230.000 eurove dhe deri më tani, që nga viti 2011, nga ky fond janë realizuar gjithsej 23 projekte të ndryshme.

Batalioni i Dytë i BRSH-së realizoi marshin 'Marsi-2016'



Komanda e Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSh) dhe Batalioni i Dytë (BAT2) i kësaj Brigade realizoi marshimin kondicional 20 kilometërsh "MARSI 2016".Ky aktivitet është realizuar në bazë të planit vjetor të aktiviteteve dhe trajnimeve për vitin 2016.Marshimi është realizuar sipas planit të përgatitur nga Komanda e BAT2, marshimi administrativ-kondicional " MARSI 2016 " në gjatësi prej 20 kilometra, i cili është realizuar ne rajonin e Deçanit, në zonën e përgjegjësisë së BAT2 të BRSH-së.Marshimi është realizuar me një efektiv prej 219 pjesëtarëve dhe 19 automjeteve. Pika e nisjes së marshimit ka qenë nga fshati Isniq tek lapidari i heroit të kombit Isa Boletini duke vazhduar deri në Deçan ku janë bërë nderime ushtarake tek lapidarët e kombit tek heronjtë e UÇK-së Luan Haradinaj dhe Sali Çekaj, pastaj marshimi ka vazhduar për në Gllogjan ku të gjithë pjesëtarët marshues kanë bërë nderime ushtarake në memorialin "DESHMORËT E KOMBIT". Gjatë realizimit të këtij marshimi përkrahja e popullatës dhe e Kuvendit Komunal të Deçanit kanë qenë elementë frymëzues për pjesëtarët që kanë marrë pjesë në këtë marshim.Marshimit i kanë prirë komandanti i BRSH-së kolonel Xhevahir Geci dhe komandanti i Batalionit të 2-të nënkolonel Mehmet Lldrovci.Qëllimi i këtij marshimi është testimi dhe mbajtja e kondicionit fizik të pjesëtarëve në distanca të gjata, gjë që ky qëllim është arritur bazuar në faktin që të gjithë pjesëtarët pjesëmarrës marshimin e kanë përfunduar me kohë dhe pa ndonjë problem.



Kadetët e QSU-së realizuan trajnimin fushor "Pëllumbi 01-2016"

Qendra për Studime Universitare (QSU) e Komandës së Doktrinës dhe Shërvitjes(KDS) e FSK-së, për kadetët e saj, nga data 26.02.2016 deri më datë 01.03.2016, ka mbajtur trajnimin fushor "Pëllumbi 01-2016". Trajnimi kishte për qëllimi përvetësimin dhe ngritjen e njohurive të përgjithshme taktike dhe teknike të kadetëve të QSU-së për luftërat në qendrat e banuara. Gjatë këtij trajnimi kadetët e viti të IV-të dhe të III-të patën mundësi që t'i zhvillojnë aftësitë e tyre udhëheqëse dhe planifikimin e operacioneve për t'i komanduar njësitë e tyre në luftërat urbane. Ndërsa kadetët e vitit të II-të dhe të I-rë ushtruan taktikat dhe teknikat ushtarake të nivelit bazik, si dhe trajnime ekipore në nivel skuadre për luftimet në qendra urbane. Aktivitetet që u realizuan gjatë këtij trajnimi ishin: Lëvizjet taktike në qendra të banuara; pozicionet luftuese në qendra të banuara; kordonkërkimi;drillet e betejës, pastrimi i objektit(dhomave) si dhe navigim tokësor natën dhe ditën. Gjatë realizimit të trajnimit, kadetët e QSU-së u treguan mjaft të motivuar dhe të përkushtuar për arritjen e objektivave të trajnimit.

Pjesëtarëtë FSK-së certifikohen për lëvizje taktike me automjete të blinduara „Kobra"



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe ambasadorja fuqiplotë e Republikë së Turqisë në Republikën e Kosovës, znj. Kivilcim Kiliç vizituan kazermën e FSK-së ,,Ushtarët e NATO-s" në Istog për të marrë pjesë në ceremoninë e certifikimit të trajnimit ,,Mbështetje dhe lëvizje taktike me automjetet e blinduara ,,Kobra", të mbajtur nga ushtarakë të Forcave të Armatosura të Turqisë.Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, para mysafirëve dhe 39 ushtarakëve të FSK-së të rreshtuar për certifikim, tha se: ,,njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga temat dhe stërvitjet e këtij trajnimi, të ofruara nga specialistët turq, do të shërbejnë për ngritjen profesionale të pjesëtarëve të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë si dhe do të ndikojnë në kapacitetet operuese të njësisë".Gjeneral Rama, nëpërmjet ambasadores Kiliç falënderoi shtetin e Turqisë dhe Forcat e saj të Armatosura për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme qe ato kanë dhëne dhe po vazhdojnë të japin për FSK-në.Më tej, komandanti i FSK-së tha se Forca e Sigurisë së Kosovës ka standardizuar këto automjete të blinduara, pra blindat e tipit ,,Kobra" dhe se trajnimi për mirëmbajtje, drejtim dhe lëvizje taktike me kobrat është domosdoshmëri dhe se këtë trajnim duhet zhvilluar edhe në të ardhmen edhe në njësitë tjera.Në fund, gjeneral Rama tha se FSK-ja po ndërton standard në të gjitha drejtimet, pra standard mbi bazën e standardeve të NATO-s, dhe ky sistem na mundëson që të jemi të ndervepruesh me partnerët tanë.Ne, tha komandant Rama, pra FSK-ja çdo ditë po e dëshmon profesionalizmin falë përkrahjes që e kemi nga partnerët tanë, në këtë rast nga shteti turk.Gjithashtu edhe ambasadorja e Republikës së Turqisë, Kivilcim Kiliç u shpreh e lumtur që Forcat e Armatosura të shtetit të saj kanë kontribuar në zhvillimin dhe përfundimin me sukses të këtij trajnimi. Ajo tha se shteti turk është i përkushtuar që të mbështesë Forcën e Sigurisë së Kosovës me shkollime dhe trajnime edhe në të ardhmen.Ambasadorja, në fund, i falënderoi komandantin e FSK-së dhe të gjithë ushtarët, të cilët siç tha Ajo po nda bëjnë të ndihemi si në shtëpinë tonë, si dhe komandantin e Kontingjentit turk për punën dhe bashkëpunimin me FSK-në.Edhe kolonel Xhevahir Geci, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë tha se trajnimi për shofer, mirëmbajtje dhe manovrim taktik me autoblinda është një prej trajnimeve më të rëndësishme për BRSh-në. Ai, gjithashtu tha se përfundimi me sukses i trajnimit të pjesëtarëve të Komandës së BRSh-së dhe Batalionit të 2-të e bënë këtë njësi shumë më të gatshme për të kryer misionin e saj.Kolonel Geci me këtë rast falënderoi ekipet trajnuese të Ushtrisë së Republikës së Turqisë për punën dhe angazhimin e tyre gjatë realizimit të trajnimit.Ndërsa, komandanti i Kontingjentit turk në kuadër të KFOR-it në Kosovë, kolonel Saim Bagci u shpreh i lumtur që trajnimi për mirëmbajtje, drejtim dhe manovrim me autoblinda, të cilin e zhvilluan ekipet nën komandën e tij, përfundoi me sukses, Ai premtoi vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen.Në fund të ceremonisë u ndanë certifikatat për të gjithë pjesëtarët e Batalionit të Dytë dhe të Komandës së BRSh-së, si dhe certifikata për më të dalluarit. Gjithashtu, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama ndau mirënjohje për të gjithë trajnerët e ekipet trajnues të Kontingjentit ushtarak turk.Në emër të pjesëtarëve të certifikuar falënderoi kapiteni Kreshnik Zeneli, i cili vlerësoi lart angazhimin, disiplinën dhe përkushtimin e pjesëtarëve gjatë realizimit të kursit për manovrim me automjetet e blinduara ,,Kobra", të cilin e cilësoi si mjaft të dobishëm.Në ceremoni morën pjesë edhe ushtruesi i detyrës së komandantit të Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral Gëzim Hazrolli, nënkryetari i Kuvendit Komunal të Istogut, Lulzim Blakaj, komandanti i Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë, nënkolonel Mehmet Lladrovci si dhe oficerë, nënoficerë dhe ushtarë të FSK-së.

FORCA JONË

□□□ Viti V □ Nr. 46 □maj 2016 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Ministri Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rama vizitë zyrtare në SHBA

Takime të rëndësishme në Pentagon, Uashingon DC dhe në shtetin Ajova

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës Haki Demolli, së bashku me komandantin e FSK-së, gjeneralljeënant Rrahman Ram dhe një delegacion të Minsitrisë dhe FSK-së, ditë më parë realizuan një vizitës zyrtare pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Delegacioni i MFSK-së dhe FSK-së, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si në Pentagon, në Uashington DC, në shtetin e Ajovës, etj, realizoi takime zyrtare me personalitete të larta shtetërore dhe ushtarake të SHBA-ve. Takime zhvilluam me shefin e Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjeneralin Frank Grass, me gjenerallejtënant Keneth Mekenzi Shef i J-5 (Drejtor për Politika dhe Planifikimet Strategjike) të Komandës së Bashkuar të Ushtrisë së SHBA-ve, me Guvernatorin e shtetit Aiova, Terry Branstad, komandantin e Gardës Kombëtare të Aiovës, gjeneral Timothy Orr,etj.

□inistri □he □o□an□anti i □□K-së □pritën në Penta□on n□a □jenerali □ran□ □rass

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Ramau pritën zyrtarisht në Pentagon nga shefi i Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës(ShBA), gjenerali Frank Grass. Në takimin ishte i pranishëm edhe shefi i Gardës Kombëtare të Aiovës, gjeneral Timothy Orr, (Shteti i Ajovës me shtetin e Kosovës është në partneritet e gjithashtu FSK-ja me Gardën e Ajovës) u bisedua për marrëdhëniet Kosovë-ShBA në fushën e sigurisë, procesi i transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës(FAK), si dhe çështje e tema tjera me rëndësi nga siguria. Ministri Demolli nga ana e tij e përgëzoj mikpritësin, gjeneralin Grass për bashkëpunimin e mirë ndërmjet dy vendeve dhe dy institucioneve duke e falënderuar atë edhe për mbështetjen e vazhdueshme që ShBA-ja ka dhënë dhe vazhdon të jap për Kosovën dhe Forcën e Sigurisë në veçanti. Gjithashtu, ministri Haki Demolli e njoftoi gjeneralin Grass mbi mbarëvajtjen e procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për hapat, përgatitjet që janë bërë si dhe për planet për zhvillimin e saj. Ministri Demolli shprehu gatishmërinë për transparencë të plotë me faktorët vendorë, strategjikë dhe ndërkombëtarë sa i përket procesit të transformimit të FSK-së në FAK. Nga ana e tij, gjenerali Grass, shef i Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shprehu mbështetje për procesin dhe mbështetje për përpjekjet e institucioneve të Kosovës, për krijimin e infrastrukturës që garanton një ambienti të qetë dhe të sigurt në Republikën e Kosovës. Gjenerali Frank Grass, shef i Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për nderë të ministri Demolli, gjeneralit



Rama dhe delegacionit nga MFSK-ja, shtroi një drekë zyrtare në Pentagon, në shenjë respekti për bashkëpunimin e deritanishëm si dhe për planet intensive të bashkëpunimit në të ardhmen. Në takimin e delegacionit nga Kosova në Pentagon, ishte i pranishëm edhe atasheu i FSK-së, pranë Ambasadës së Republikës së Kosovës në Uashington, gjeneral brigade Xhavit Gashi, shefi i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtarë, kolonel Ilir Qeriqi, si dhe oficerë e nënoficerë të tjerë të Forcës së Sigurisë..

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën admiralin Mark Ferguson III



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramën, më 28 prill, pritën në takim komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara të Aleancës (KFBA) në Napoli, admiralin Mark E. Ferguson III, i cili shoqërohej edhe nga komandanti i Forcave Paqeruajtëse të KFOR-it, gjeneral major Guglielmo Luigi Miglieta. Ministri Demolli, fillimisht, i dëshiroi mirëseardhje admiralit Ferguson dhe më pas e njoftoi atë me të arriturat dhe zhvillimet e përgjithshme në MFSK dhe FSK, bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me KFOR-in dhe me ekipet këshilluese ndërlidhëse të NATO-s për FSK-në (NLAT-it dhe NAT-it). Gjithashtu ministri Demolli dhe gjeneral Rama e njoftuan admiralin Ferguson për vizitën e tyre në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata njëherësh shprehën mirënjohjen e tyre të thellë për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së për Kosovën dhe në veçanti për zhvillimin e proceseve në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministri Demolli po ashtu e njoftoi admiralin Ferguson lidhur me dinamiken e zhvillimeve të FSK-së drejt transformimit në Forca të Armatosura të Kosovës. Nga ana e tij, komandanti i Komandës së Bashkuar të Forcave të Aleancës në Napoli, admirali Ferguson, vlerësoi lart zhvillimet dhe të arriturat e FSK-së në përgjithësi. Ai shtoi se siguria në Kosovës është jashtëzakonisht e mirë dhe se Kosova është një histori suksesi. Admirali Ferguison po ashtu theksoi se KFOR-i në Kosovë do t'i mbajë edhe më tej forcat e veta me kapacitet që ka, më qëllim të afrimit të sigurisë së përgjithshme. Në fund, ministri Demolli dhe gjeneral Rama, edhe një herë e falënderuan admiralin Ferguson për angazhimin dhe përkrahjen e tij të vazhdueshme për sigurinë në Kosovë dhe veçanërisht për zhvillimin e FSK-së. Në takimi ishin të pranishëm edhe zëvendësministri i parë i FSK-së, Fadil Gashi dhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

FSK-ja më e besueshmja për qytetarët e Republikës së Kosovës

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) vazhdon të jetë ndër institucionet më të besueshme në Kosovë, sipas të dhënave të publikuara më 13 prill, nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), , me temën: "Monitorimi i Sektorit të Sigurisë së Kosovës: nëntor 2015-mars 2016". Rritjen më të madhe të besueshmërisë, nga të gjithë udhëheqësit në sektorin e sigurisë e ka shënuar ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli më 0.14. Pra ministri Demolli sipas ,,KIPRED", dhe rezultateve të opserverit ka besueshmëri në shkallë 3.00 për qind, përderisa vitin e kaluar, pra gjatë vitit 2015, kjo besueshmëri ishte në shkallë 2.86. ,,KIPRED" në paraqitjen e numrit të tretë të vëllimit të parë të Observerit të Sektorit të Sigurisë së Kosovës, ka kumtuar se në bazë të analizës së rezultateve të hulumtimit ka dalë se FSK-ja prin me besueshmëri nga ana e qytetarëve me 3.69 për qind, të të gjithë të anketuarve në gjithë Kosovën. Krahasuar me të dhënat e hulumtimit të realizuar në hulumtimin paraprak, në nëntor 2015, del se shkalla e besueshmërisë është rritur nga 3.58 në 3. 69 për qind, pra rritje është shënuar për 0.11 për qind. Forca e Sigurisë së Kosovës është ndër institucionet më të besueshme në vend sipas të gjitha hulumtimeve dhe anketimeve në pesë vitet e kaluara, dhe len pas kështu vazhdimisht të gjitha institucionet tjera të sigurisë në nivel vendi.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama vizitë zyrtare në Shqipëri

Ushtria Shqiptare mbështet FSK-në



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës-FSK, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të shefit të Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneral major Jeronim Bazo, më 29 prill, u prit me nderime të larta ushtarake shtetërore në Ministrinë e Mbrojtjes, në Tiranë. Fillimisht, gjeneral Rama i shoqëruar edhe nga gjeneralët Bashkim Jashari dhe Zymer Halimi, atasheu ushtarak i Kosovës në Tiranë, nënkolonel Enver Dugolli, u pritën në Ministri nga ministrja e Mbrojtjes, zonja Mimi Kodheli. Në takim u bisedua për bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.**(vijon në faqen 4)**

Ministri Demolli ngushëllon ministren shqiptare të Mbrojtjes zonjën Kodheli

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli në emër të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës i ka dërguar një telegram ngushëllimi, ministres së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, znj Mimi Kodheli, me rastin e vdekjes në detyrë të dy oficerëve të Forcave Ajrore Shqiptare, pas aksidentit të helikopterit të Ushtrisë shqiptare. Në tekstin e letrës ndër të tjera thuhet: ,,Me keqardhje morëm lajmin për vdekjen aksidentale të dy oficerëve të Forcave Ajrore të Republikës së Shqipërisë, të dy jetëve të reja, kapiten Florian Deliaj dhe toger Donald Hoxha. Në telegramin e ngushëllimit, ministri Demolli e ngushëlloi ministren Kodheli në emër të gjithë oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve dhe shërbyesve civilë të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës ,,Zonja e nderuar, ministre Kodheli, në emër të oficerëve, nënoficerëve ushtarëve dhe stafit civil të Ministrisë për Forcën e Sigurisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës, më lejoni që të shpreh ngushëllime të sinqerta, vëllazërore për Ju si Ministre, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe familjet e të rënëve në detyrë. Më tej, ministri Demolli ka shprehur edhe dëshirën që ushtaraku i mbijetuar në aksidentin tragjik të Forcave Ajrore shqiptare të shërohet sa më shpejt: ,,E nderuara ministre Kodheli, të mbijetuarit, ushtarakut të nderuar Gerald Baramuça i dëshiroi shërim, si dhe kthim të shpejt në detyrë, për të vazhduar misionin e tij. Në fund të telegramit të ministrit Demolli thuhet: ,,Ne besojmë thellësisht se Ju, ministre Kodheli dhe Forcat e Armatosura shqiptare do të dinë ta përballojnë humbjen e dy oficerëve të respektuar.

Në ministri u mbajt konferenca ,,FSK dhe partnerët”

Nën organizimin e Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), në lokalet e ministrisë, më 1 prill, u zhvillua konferenca „FSK dhe partnerët", ku morën pjesë atashetë ushtarakë të akredituar në Republikën e Kosovës dhe në shtete të rajonit. Të pranishëm në ceremoninë e hapjes së kësaj konference ishin edhe ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, z. Shkelzen Sylaj, si dhe oficerë e zyrtarë tjerë të lartë të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në hapje të konferencës një fjalë rasti e mbajti ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, i cili tha se qëllimi i kësaj konference është intensifikimi i bashkëpunimit dypalësh ndërmjet FSK-së dhe partnerëve të saj, si dhe sinkronizimi i veprimeve ndërmjet të gjithë partnerëve të FSK-së në rrafshin e përkrahjes dhe bashkëpunimit me FSK-në. Në këtë rrafsh rol të madh kanë dhe gjithsesi do të kenë edhe në të ardhmen edhe dy ekipet këshilluese të NATO-s, Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s për FSK-në (NLAT) dhe Ekipi Këshillues i NATO-s për Ministrinë (NAT), si mekanizma mbështetës të Ministrisë dhe FSK-së, tha .Ministri Demolli. Ministri më tutje tha se: "duke u bazuar në rezultatet e konferencës së



kaluar, me plot të drejtë mund të konstatojmë se kemi pasur një progres të konsiderueshëm në ushtrimin e aktiviteteve mbështetëse, e në veçanti në fushën e standardizimit dhe sinkronizimit të aktiviteteve të përbashkëta që janë ndërmarrë mbi bazën e kërkesave tona konkrete." Ministri Demolli, i njoftoi të pranishmit se MFSK-ja, respektivisht FSK-ja është duke vazhduar që me përpikëri t'i përmbushë detyrat në misionin e saj të paraparë me Kushtetutën e vendit, dhe në të njëjtën kohë është duke punuar në përgatitjen dhe planifikimin e ndryshimit të misionit tonë, respektivisht në ngritjen e kapaciteteve për misionin e ri kushtetues të forcave tona. Më tej ministri i FSK-së theksoi se: „i tërë procesi i planifikimit për misionin e ri kushtetues është duke u zhvilluar në mënyrë transparente, d.m.th duke këmbyer informata me të gjithë faktorët relevantë politikë vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe duke u konsultuar dhe bashkëpunuar me mekanizmat ndërkombëtarë të rëndësishëm të sektorit të sigurisë Duke pasur parasysh vonesën që lidhet me procesin e transformimit, kjo po ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Kosovës, pastaj në motivimin e pjesëtarëve të saj, si dhe në pritjet e qytetarëve të Kosovës". Kjo konferencë ka për qëllim përgatitjet paraprake të FSK-së dhe partnerëve dhe koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta në përputhje me konceptet euroatlantike „mbrojtja e mençur" dhe ,,mbledh dhe shpërndaj". Ai tha gjithashtu se: „në të njëjtën kohë jemi duke u munduar që të kanalizojmë fushat e mbështetjes, respektivisht t'i paraqesim para jush kërkesat dhe nevojat tona në mënyrë që të shfrytëzojmë në mënyre sa më racionale kapacitetet, me kosto sa më të ulët dhe me qëllim final rritjen e ndërveprueshmërisë". Ministri Demolli në fund paralajmëroi se konferenca „FSK dhe Partnerët" dhe konferenca ,,Qasje gjithëpërfshirëse të asistencës së Forcës dhe FSK" do të jenë një aktivitet i përbashkët. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se pjesëmarrja e delegacioneve të shteteve mike tregon për përkushtimin e tyre për të mbështetur Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke i cilësuar edhe sukseset e Forcës së Sigurisë si fryt i bashkëpunimit të jashtëzakonshëm me vendet partnere. Ai gjithashtu tha se synimi ynë është që të ngrisim kapacitetet tona dhe të jemi transparent në procesin e ardhshëm. Ndërsa drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Ernst Horn përshëndeti punimet e konferencës, "FSK dhe Partnerët" dhe tha se ka vetëm gjashtë javë në këtë detyrë, por ka arritur që të njoftohet me gjithë strukturën, njësitë, kazermat dhe me gjithë stafin komandues për të cilët pati fjalë të mira. Gjenerali Horn, gjithashtu çmoi lartë profesionalizimin dhe motivimin e pjesëtarëve të FSK-së gjatë trajnimeve dhe ushtrimeve. Ai vlerësoi lart autoritetin e FSK-së, si dhe kërkoi nga pjesëmarrësit që të gjejnë forma dhe mënyra mbështetjeje për FSK-në tek vendet dhe institucionet e tyre. Gjithashtu koloneli Tod Jacobus, zëvendës drejtor i Ekipit Këshillues të NATO-s për FSK-në, çmoi rolin e partnerëve të FSK-së, si dhe koordinimin dhe progresin e arritur si fryt i këtij bashkëpunimi. Prezantimin për punën dhe aktivitetet e realizuara ndërmjet dy konferencave e paraqiti kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim e Siguri, i cili foli mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në mes Ministrisë dhe shteteve partnere, planet për ndërtimin e partneritetit edhe me shtete tjera, pjesëmarrja në konferenca rajonale dhe më gjerë, shtrirja e rrjetit të atasheve edhe në disa shtete tjera në të ardhmen, si dhe mbi planet për bashkëpunim me aleatët në të ardhmen. Diskutuesit paraqitën ofertat dhe planet për mbështetje të FSK-së, si dhe debatuan mbi mënyrat dhe realizimin e projekteve të përbashkëta. Në punimet e konferencës morën pjesë dhe kontribuuan me prezantime të tyre atasheu ushtarak i Republikës së Shqipërisë, kolonel Fiqri Hoxha, kolonel Chad Buts, atashe ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kolonel Ivica Mateshiq nga Kroacia, zonja Jana Kalman, zëvendësshef i misionit të Republikës së Çekisë, kolonel Yoshimata Taki nga Japonia, kolonel Donce Kusmanov nga Maqedonia, nënkolonel Richard Perry, atashe ushtarak i Britanisë së Madhe etj. Konferenca „FSK dhe Partnerët" tani më ka bërë një traditë dhe zhvillohet në dy sesione, në sesionin pranveror dhe atë vjeshtor, me qëllim të bashkërendimit dhe mbështetjes së aktiviteteve të përbashkëta.

Sekretari i përgjithshëm dr. Shkëlzen Syla priti në takim shefin e mjekësisë të Ushtrisë gjermane, gjenerallejtënant Michael Tempel

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Shkëlzen Sylaj, më 20 prill, priti në takim një delegacion të Forcave të Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë, të fushës së mjekësisë, të udhëhequr nga gjenerallejtënant dr. Michael Tempel. Në takimin e përbashkët të sekretarit Sylaj me delegacionin gjerman ishin të pranishëm edhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendës komandant i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, shef i Departamentit të Mjekësisë në Ministri, Florin Hoxha, asistent personal i sekretarit të përgjithshëm, si dhe zëvendëskomandanti i Kompanisë së Mjekësisë, major dr. Genc Shala. Gjatë takimit, fillimisht, sekretari Sylaj i shprehu mirëseardhje delegacionit të Forcave të Armatosura gjermane, duke i falënderuar ata për kujdesin që shteti gjerman ka treguar dhe po vazhdon të tregojë në përgjithësi për Kosovën dhe në veçanti për bashkëpunimin e mirë dhe intensiv me Ministrinë dhe me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Veçanërisht ai potencoi faktin se donacioni i parë në pajisje për FSK-në ka qenë donacioni me automjete qe shteti dhe populli gjerman pati ndarë atë kohë për FSK-në, e gjithashtu edhe për kontributin që ka dhënë Kontingjenti gjerman i KFOR-it në Prizren, në fakt Spitali Ushtarak Gjerman në Prizren për pacientët në nevojë që nga paslufta e deri tani. Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, dr. Shkelzen Sylaj e njoftoi gjeneralin Tempel për funksionimin e deritanishëm të kujdesit mjekësor në FSK, si dhe për planet për zhvillimin e tij në të ardhmen. Më tej dr. Sylaj e njoftoi delegacionin gjerman edhe lidhur me rrjetin e shërbimeve mjekësore brenda njësive dhe kazer-



mave të FSK-së, me kapacitet ekzistuese dhe shërbimet që ofrohen, si dhe me objektivat për zhvillimin e këtij resori brenda FSK-së. Ai po ashtu i njoftoi edhe me objektin e Qendrës Mjekësore të Forcës dhe me planet e Ministrisë për pajisjen e këtij objekti sipas standardeve të funksionimit të qendrave të tilla. Sekretari Sylaj duke parë edhe gatishmërinë e palës gjermane për mbështetje, si dhe bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë, ceku konkretisht disa prej nevojave imediate të cilat do të iniciohen për realizimin në fushën e mjekësisë në të ardhmen. Nga ana e tij, gjenerallejtënant dr Michael Tempel (Surgeon General of the Bundeswehr), shef i shëndetësisë në Forcat e Armatosura të Gjermanisë u shpreh i gatshëm për mbështetjen e FSK-së në fushën e mjekësisë, me trajnime për personalin e saj dhe ofrimin e donacioneve në pajisje, si dhe në përgjithësi u shpreh i gatshëm për thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Më tej, gjenerallejtënant dr Michael Tempel, dhe delegacioni që ai shoqëronte së bashku me gjeneral brigade Gëzim Hazrollin dhe kolonel dr. Xhevdet Tahiraj vizituan objektin e Qendrës Mjekësore të Forcës ku u njohën nga afër me infrastrukturën dhe kapacitete ekzistuese të kësaj qendre. Pjesë e delegacionit gjerman ishin edhe shefi i Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në (NLAT), gjeneral brigade Peter Horn, kolonel Roland Schnaider nga Departamenti i Mjekësisë në Komandën Operacionale gjermane, kolonel Wolfgang Mika, shef i degës mjekësore në NLAT, kolonel Ulrich Schwederski, nga departamenti mjekësor në KFOR si dhe kolonel Matti Lehesjoki, këshilltar mjekësor në kuadër të NLAT-it.

Ministri dhe komandanti i FSK-së në Uashington DC priten nga gjenerali Keneth Mekenzi

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama pas vizitave të shumta që patën në ShBA, përkatësisht në shtetin e Ajovës, më 20 prill kanë vazhduar vizitën e tyre në Uashington DC. Ministri dhe komandanti i FSK-së gjatë vizitës së tyre në Uashington DC, fillimisht bënë homazhe tek ,,Varri i ushtarit të panjohur". Më pas komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama takoi gjenerallejtënant Keneth Mekenzi (Kenneth F. McKenzie) Shef i J-5 (Drejtor për Politika dhe Planifikime Strategjike) të Komandës së Bashkuar të Ushtrisë së SHBA-së. Gjatë takimit komandant Rama e njoftoi gjeneralin Mekenzi për zhvillimet dhe arritjet e FSK-së, si dhe lidhur me procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura (FAK). Me këtë rast gjenerali Mekenzi edhe një herë konfirmoi mbështetjen e SHBA-së për FSK-në edhe në të ardhmen pas transformimit të saj në FAK. Ai po ashtu e njoftoi komandantin Rama edhe me lajmin e mirë për pranimin e dy kadetëve të FSK-së në akademinë ushtarake në Vest Point (West Point), akademi kjo me traditë të gjatë mbi 200 vjeçare dhe më e njohura në botë. Dy kadetët e pranuar të FSK-së janë Arilena Shala dhe Ylli Dalladaku. Delegacioni i MFSK-së dhe FSK-së me në krye ministrin Haki Demolli dhe komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramën do të vazhdojnë takimet në Pentagon, në Departamentin e Shtetit dhe në Këshillin Kombëtar të Sigurisë.



Gjenerallejtënant Rrahman Rama realizoi takime të rëndësishme në Shtetin Ajovës të SHBA-ve

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama me ftesë të komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës, qëndroi për një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 20 prill, u prit nga guvernatori i shtetit të Aiovës, Terry E. Branstad. Ky takim ishte edhe një lloj konfirmimi për vazhdimin e bashkëpunimit në kudër të partneritetit shtetëror të Republikës së Kosovës dhe shtetit të Aiovës. Fillimisht, gjeneral Rama e falënderoi guvernatorin Branstad për përkrahjen që shteti i Aiovës i ka dhënë dhe po vazhdon t'i jap, gjatë këtyre viteve, shtetit të Kosovës si dhe Forcës së Sigurisë



së Kosovës në veçanti. Ai po ashtu e njoftoi guvernatorin edhe me zhvillimet e fundit, të arriturat si dhe planet për të ardhmen e FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama dhe guvernatori i shtetit të Aiovës, Terry Brandstad, gjatë takimit shprehen gatishmërinë e tyre për thellimin dhe avancimin e bashkëpunimit në kuadër të ,,Partneritetit shtetëror Kosovë - Ajovë". Më tej gjatë vizitës në ShBA, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama zhvilloi një takim edhe me komandantin e Gardës Kombëtare të Aiovës, gjeneralin Timothy Orr. Me këtë rast, gjeneral Rama e falënderoi gjeneralin Orr për përkrahjen që Garda Kombëtare e Ajovës ka dhënë për FSK-në. Ai gjithashtu e njoftoi atë edhe mbi të arriturat e FSK-së, si dhe me planet dhe synimet e saj për të ardhmen. Ndërsa, nga ana e tij, gjenerali Orr e konfirmoi edhe një herë gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në shumë fusha, ashtu edhe siç janë paraparë në marrëveshjen e bashkëpunimit. Gjatë takimit të përbashkët në mes dy delegacioneve, delegacionit të Forca e Sigurisë së Kosovës në krye me gjeneral Ramën dhe delegacionin pritës të Gardës së Aiovës, u bënë dy prezantime, njëri për të arriturat e FSK-së dhe tjetri për bashkëpunimin e FSK-së me Gardën e Ajovës. Gjeneral Rama së bashku me atasheun e FSK-së në ShBA, gjeneral brigade Xhavit Gashin dhe shefin e Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, kolonel Ilir Qeriqin, vizituan edhe ambientet trajnuese dhe stërvitore të Gardës Kombëtare të Aiovës, ku së bashku me përfaqësuesit e kësaj garde u rakorduan për mundësitë e bashkëpunimit në fushën e trajnimit dhe të shkëmbimit të përvojave në përgjithësi në fushën e sigurisë.

Ministri i FSK-së Haki Demolli u takua me komandantin e KFOR-it, gjeneral Guglielmo Miglieta

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli u takua, më 13 prill, në bazën e KFOR-it, me komandantin e kontingjentit ushtarak të KFOR-it, në Kosovë, gjeneral major Guglielmo Luigi Miglieta. Gjatë takimit të ministrit Demolli me gjeneralit Miglieta u bisedua për situatën e sigurisë në vend, procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë me Komandën dhe KFOR-in në përgjithësi. Me këtë rast, Ministri Demolli e njoftoi komandantin e KFOR-it, gjeneralin Miglieta mbi zhvillimin, profesionalizmin si dhe shkallën e përgatitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës për t'u transformuar në Forca të Armatosura, në momentin që do të merret vendim, nga institucionet më të larta të shtetit të Kosovës. Ministri



Demolli konfirmoi edhe një herë se procesi i transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura plotësisht do të jetë transparent. Ai njëherësh u shpreh i gatshëm për transparencë të plotë përgjatë gjithë procesit të transformimit. Nga ana e tij, komandanti i KFOR-it, gjeneral Guilielmo Miglieta konfirmoi gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e gjithashtu edhe gatishmërinë për garantimin e paqes dhe sigurisë, në të mirë të funksionimit të jetës së qetë dhe të sigurt në Republikën e Kosovës.

Gjeneral Bashkim Jashari mori pjesë në simpoziumin ,,Luftimet Ajrore" në Turqi

Shefi i Inspektoratit në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), gjeneral brigade Bashkim Jashari, me ftesë të komandantit të Forcave Ajrore të Ushtrisë së Republikës së Turqisë, gjeneral me katër yje Abidin Ynall, më 1 prill, mori pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar të Luftimeve Ajrore, i cili u mbajt nga data 30 mars deri më 01 prill, në Stamboll të Republikës së Turqisë. Gjeneral Bashkim Jashari në emër të Ministrisë dhe FSK-së mori pjesë në punimet e konferencës reditore të organizuar nga Akademia e Luftës Ajrore, me temë ,,Luftimet Ajrore", e ku ishin të pranishëm më se 60 delegacione të Ministrive të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura nga të gjitha kontinentet. Përveç pjesëmarrjes në konferencë, gjeneral Bashkim Jashari u prit edhe nga komandanti i Forcave Ajrore, gjeneral Ynall, të cilin e falënderoi për ftesën si



dhe për kontributin dhe mbështetjen që po japin Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë për Forcën e Sigurisë dhe Republikën e Kosovës në përgjithësi. Nga ana e tij, gjeneral Abidin Ynall u shpreh i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit Turqi-Kosovë si dhe premtoi mbështetje dhe përkrahje edhe në të ardhmen në të gjitha fushat sipas marrëveshjes zyrtare dypalëshe, ndërmjet të dyja shteteve në fushën e sigurisë. Në këtë simpozium, gjeneral Bashkim Jashari ishte i shoqëruar nga dy oficerët e MFSK-së, nënkoloneli Sefer Isufi dhe togeri Ilir Beqiri.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ushtria Shqiptare mbështet FSK-në

(vijon nga faqja e parë)

Nga të dyja palët u shpreh gatishmëria e plotë për bashkëpunim në fushën e sigurisë në të ardhmen. Më tej, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama me bashkëpunëtorë, zhvilloi takim kokë më kokë me shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura Shqiptare, gjeneral major Jeronim Bazo. Në takimin e përbashkët të dy gjeneralëve u bisedua për bashkëpunimin rajonal në këtë fushë, si dhe për bashkëpunimin e Ministrisë për FSK dhe Forcës së Sigurisë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama dhe delegacioni nga Ministria për Forcën e Sigurisë, në përbërje: gjeneral brigade Bashkim Jashari, shef i Inspektoratit, gjeneral brigade Zymer Halimi, shef i Drejtorisë për Operacione, Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane, atasheu ushtarak i Kosovës, nënkolonel Enver Dugolli dhe drejtori i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, Ibrahim Shala, zhvilluan një takim të zgjeruar të delegacioneve, kryesuar nga gjeneral Bazo dhe gjeneral Rama. Gjeneral Rama me këtë rast, e njoftoi gjeneralin Bazo mbi procesin që po kalon ministria për FSK dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, procesin e bashkëpunimit regjional si dhe procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura. Nga ana e tij gjeneral Rama tha se pikërisht në këtë proces është shumë e nevojshme përvoja e Ushtrisë shqiptare e cila pothuajse ka kaluar sfida të ngjashme, në rrugën e zhvillimit të saj. Nga ana e tij, shefi i Ushtrisë shqiptare, gjeneral Bazo tha se e gëzon fakti i sukseseve gjithnjë e më të mëdha të Forcës së Sigurisë, duke u zotuar për një bashkëpunim intensiv në të gjitha fushat e nevojshme dhe se siç u shpreh Ai, „Ne do jemi zëri juaj, aty ku ju nuk jeni, dhe do mundohemi të ju mbështesim edhe aty ku ne nuk jemi".



Gjenerali Bazo tha gjithashtu se mbështetja për Forcën e Sigurisë do të jetë e sinqertë dhe konkrete, për avancimin dhe depërtimin e saj në iniciativa rajonale dhe globale në fushën e sigurisë. Të dy shefat, gjeneral Rama dhe gjeneral Bazo u dakorduan se bashkëpunimi rajonal është në interes të të gjitha vendeve të rajonit dhe se ndërtimi i një klime të mirë të bashkëpunimit, lehtëson edhe integrimin e tyre më të shpejtë, si dhe anëtarësimin me të shpejt në këtë rast të Kosovës, në iniciativa rajonale dhe më gjerë. Komandanti i Forcës së Sigurisë, gjeneral Rama dhe delegacioni i Ministrisë për Forcën e Sigurisë i shoqëruar edhe nga komandanti i Forcave Tokësore shqiptare, gjeneral brigade Nazmi Cahani vazhduan vizitën në garnizonin e Njësisë Komando dhe atë të Batalionit të Forcave Speciale të Ushtrisë shqiptare, në Zall-Herr. Fillimisht, në Zall-Herr, delegacioni i MFSK-së i kryesuar nga gjeneral Rrahman Rama zhvilloi një takim të përbashkët me gjeneralin Cahani, ku u njoftuan me misionin, detyrat dhe aktivitetet e Njësisë Speciale si dhe më pastaj patën mundësi të ndjekin një demonstrim profesional me armë në poligonin për gjuajtje në garnizonin e Zall-Herr-it. Gjatë vizitës në Tiranë, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama me bashkëpunëtorë bëri një vizitë të shkurtër në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë, me ç'rast u pritën nga ambasadori Ramiz Lladrovci. Me këtë rast, gjeneral Rama i uroi ambasadorit Lladrovci detyrën dhe emërimin e tij në postin e ambasadorit fuqiplotë pranë Ambasadës së Republikës së Kosovës në Tiranë. Nga ana e tij, ambasadori Lladrovci e falënderoi gjeneral Ramën dhe delegacionin e MFSK-së për vizitën si dhe shprehu gatishmërinë për mbështetje diplomatike të FSK-së.





Gjeneral Rama përgëzoi ushtarët e FSK-së që zunë vendin e parë në garën "Ushtari më i mirë"organizuar nga KFOR-i Amerikan

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 13 prill 2016, priti dy ushtarët e Brigadës për Reagim të Shpejtë(BRSH) të FSK-së, tetarin Rafet Gashi dhe ushtarin Liridon Selimi, të cilët i përgëzoi për paraqitjen e jashtëzakonshme në garën ushtarake shumëkombëshe "Ushtari më i mirë". Kjo garë ishte organizuar nga KFOR-i amerikan në Kampin Bondsteel prej 11deri më 13 shkurt 2016, ku morën pjesë 10 ekipe të ushtrive të shteteve të NATO-s, të cilët shërbejnë në Kosovë, si nga Amerika, Gjermania, Polonia, Hungaria etj. Ekipi i FSK-së në këtë garë u përfaqësua nga tetari Rafet Gashi dhe ushtari Liridon Selimi, të cilët dolën më të mirët në të gjitha disiplinat, si: Gjuajtje me armë të shkurtra dhe të gjata, kursi i pengesave-kalitje fizike, marshim rrugor 10 km me 16 kg ngarkesë, montim dhe çmontim i armëve dhe ndihmë e parë. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë këtij takimi i përgëzoi tetarin Gashi dhe ushtarin Selimi për suksesin e arritur në këtë garë ndërkombëtare. Ai ndër të tjera u shpreh: „Me paraqitjen tuaj të shkëlqyeshme në garën për zgjedhjen e ushtarit më të mirë të organizuar nga KFOR-i amerikan, ku në mesin e 10 ekipeve të shteteve të NATO-s keni zënë vendin e parë, është një sukses i madh. Ju përgëzoj për përkushtimin dhe profesionalizmin që keni treguar dhe po tregoni gjatë shërbimit tuaj në FSK. Me paraqitjen tuaj të mirë keni nderuar jo vetëm FSK-në por edhe vetën tuaj". Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më pastaj, kërkoi angazhim maksimal edhe në të ardhmen duke marrë shembuj të mirë të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kudo ku po shërbejnë në botë, po tregojnë rezultate të shkëlqyeshme. Ky



sukses është i shkëlqyeshëm, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e ekipeve të ushtrive më të avancuara që veprojnë në kuadër të NATO-s në Kosovë, çka më bën të ndihem krenar edhe mua si komandant i FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, tetarit Rafet Gashi dhe ushtarit Liridon Selimi iu dha certifikata me motivacionin "Për arritje të jashtëzakonshme". "Duke marrë parasysh nivelin dhe konkurrencën e lartë në këto gara, kjo është arritje mjaft e lartë jo vetëm për pjesëtarët që garuan, por edhe për vetë FSK-në dhe Kosovën në përgjithësi, pasi me këtë po tregojmë se pjesëtarët tanë kanë përgatitje të lartë arsimore dhe fizike, të të njëjtit nivel edhe me shtetet e rajonit dhe ato evropiane"- tha komandanti i FSK-së. Ndërsa, tetari Rafet Gashi dhe ushtari Liridon Selimi u shprehën se ndihen të lumtur që kanë zënë vendin e parë. Ata falënderuan komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën dhe premtuan se gjithmonë do të angazhohen për të mirën e FSK-së, me qëllim të rritjes së imazhit të saj si brenda ashtu edhe jashtë shtetit.

Ministri Demolli raportoi para Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së

Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, më 29 prill, raportoi para Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për punën dhe të arriturat e FSK-së, dhe në veçanti për vizitën e tij zyrtare që pati së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Në mbledhjen e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të drejtuar nga Fadil Demaku, zëvendëskryetar, minsitri Demolli vlerësoi se një nga takimet kryesore ishte ai me shefin e Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneralin Frank Grass, ku e kishte njoftuar gjeneralin Grass mbi mbarëvajtjen e procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për hapat, përgatitjet që janë bërë si dhe për planet për zhvillimin e saj. Gjithashtu, Demolli informoi edhe për takimet e tij me shefin e Gardës Kombëtare të Aiovës, gjeneralin Timothy Orr. Ndër temat kryesore në takime ishin ato të zhvillimit të FSK-së. Demolli, ndërkaq, e njoftoi komisionin për vizionin kryesor të Ministrisë së FSK-së si, promovimin e stabilitetit në shtet dhe regjion, si dhe gatishmërinë e shtetit të Kosovës të punojë me të gjitha ministritë në regjion. Në vijim ai i njoftoi edhe për ftesën që i ishte bërë FSK-së nga NATO për pjesëmarrjen në ushtrime të 20 kadetëve, si dhe për trajnimet e organizuara nga NATO për shtetet jo anëtare. Demolli theksoi edhe partneritetin e suksesshëm me Gardën e Aiovës, dhe ndihmën e ndarë për vitin 2016 prej rreth 5 milionë dollarë nga SHBA-të për Ministrinë e FSK-së. Si sukses të lartë, Demolli vlerësoi pranimin e dy kadetëve për shkollim në West Point. Ndërkaq, e informoi komisionin edhe për procesin e transformimit të FSK-së në FAK, për Projektligjin e përgatitur dhe



amendamentet. Ai theksoi se janë bërë të gjitha përgatitjet nga ana e Ministrisë së tij, duke pohuar se pritet vetëm vendimi politik. Gjithashtu, ai i përmendi parametrat e procesit të transformimit, si: periudha (rreth dhjetë vite), rritja e personelit, buxheti që përcjell procesin e transformimit, infrastruktura dhe procesi i trajnimit. Në fund, Demolli theksoi edhe vlerësimet nga ana e partnerëve amerikanë për bashkëpunimin shumë pozitiv, intensifikimin e këtij bashkëpunimi dhe përkrahje nga ana e tyre në të gjitha proceset e MFSK-së. Pas raportimit të përmbledhur të ministrit Demolli, u zhvillua një debat ku shumë nga anëtarët e komisionit parashtruan pyetje, të cilat kishin të bënin me transformimin e FSK-së, barazinë gjinore, pjesëmarrjen e komuniteteve etj. Të gjitha pyetjeve të cilat u parashtruan iu përgjigj ministri Demolli, i cili gjithashtu i falënderoi të pranishmit për pyetjet dhe komentet e tyre.

U mbajt konferenca punuese "Plani i Integritetit i Ministrisë së Forcës së Sigurisë'

Në ambientet e MFSK-së, më 11 prill u mbajt konferenca punuese "Plani i Integritetit i Ministrisë së Forcës së Sigurisë', projekt ky i filluar që në vitin 2015 dhe i mbështetur nga Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë. Prezantimin e projekt- planit të përgatitur nga grupi punues e bëri zoti Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane në MFSK. Ministri i MFSK-së zoti Haki Demolli në fjalën e tij, vuri theksin mbi nevojën dhe rëndësinë e ekzistimit dhe funksionimit të planit të integritetit. "Ministria e FSK-së dhe FSK-ja tash e disa vite në të gjitha sondazhet e vendit, janë shpallur si institucionet me besueshmërinë më të lartë të qytetarëve. Ky vlerësim, në njërën anë na obligon që të rrisim përgjegjësinë, në drejtim që politikat kundër dukurive negative, dukurive të tjera të pa përshtatshme dhe jo etike t'i avancojmë, duke i shndërruar në standard të punës sonë menaxhuese, administrative dhe operacionale, dhe atë në të gjitha nivelet e funksionimit të MFSK-së dhe FSK-së". Ministri Demolli duke falënderuar pjesëmarrësit dhe anëtarët e grupit punues për hartimin e planit të integritetit, në vazhdim të fjalës së tij ritheksoi se: "Qëllimi kryesor i planit të integritetit është forcimi i integritetit dhe forcimi i kulturës kundër-korrupsion në sektorin publik duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate". Gjatë zhvillimeve të punimeve të konferencës me debatet e tyre kontribuuan edhe; komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkelzen Sylaj, z.Svein Eriksen, përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë, Mentor Vrajolli nga Qendra Kosovare e Studimeve të Sigurisë (QKSS), kolonel Tod Gjakobus (Todd Jacobus), zëvendës drejtor i Ekipit Këshillues të NATO-s (EKN), drejtorët e departamenteve të MFSK-së dhe të tjerë. Konferenca doli me konkluzionin që gjetjet e dala dhe propozimet e bëra të përfshihen në projektin final, ku plani do të rishqyrtohet përsëri derisa të merr formën përfundimtare. Të pranishëm në konferencë ishin edhe: zëvendësministri Muhamet Latifi, gjeneral brigade Zymer Halimi, zyrtarë dhe oficerë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së, pjesëtarë të Ekipit Këshillues të NATO-s (EKN), Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (ENKN) dhe të ftuar të tjerë.

Ministri dhe komandanti i FSK-së bënë homazhe në "Varrezat e Dëshmorëve" në Koshare

Ministri i FSK-së, Haki Demolli dhe komandanti, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me zëvendësministrin Fadil Gashi, gjeneralët e brigadës Nazmi Brahimaj dhe Gëzim Hazrolli, si dhe zyrtarë dhe oficerë të lartë të Ministrisë dhe FSK-së, më 9 prill 2016, morën pjesë në shënimin e përvjetorit të 17-të të manifestimit "Ditët e Shqipes" të Betejës së Lavdishme të UÇK-së në Koshare. Demolli dhe Rama në varrezat e dëshmorëve të Brigadës 138 "Agim Ramadani" bënë homazhe dhe në nderim të dëshmorëve të kësaj Brigade vendosën kurora me lule të freskëta, si dhe takuan familjarët e dëshmorëve të cilëve u shprehën ngushëllimet dhe krenarinë e tyre për heroizmin e bijve dhe bijave të tyre, në luftën e shenjtë që bënë për thyerjen e kufirit Kosovë-Shqipëri. Gjithashtu, ministri dhe komandanti së bashku



me delegacionin e MFSK-së, përcollën edhe manifestimin "Ditët e shqipes" organizuar nën patronatin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Isa Mustafës.

Drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane mori pjesë në konferencën e drejtorëve "ShBA-Karta e Adriatikut A5"

Drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Faruk Geci me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, më 15 prill 2016, mori pjesë në konferencën e drejtorëve për politika dhe plane të ministrive të Mbrojtjes dhe ministrive të Punëve të Jashtme, në kuadër të „ShBA-Karta e Adriatikut A5". Në konferencë e pranishme ishte edhe ambasadorja e Republikës së Kosovës në Republikën e Kroacisë, znj. Shkëndije Geci-Sherifi. Gjatë konferencës ndër të tjera u diskutu lidhur me sfidat e tanishme të sigurisë me theks të veçantë terrorizmi dhe luftëtarët e huaj. Në këtë kuadër, në fjalën e tij, drejtori i Politikave dhe Planeve në MFSK, Faruk Geci theksoi se angazhimet e ndërmarra nga Republika e Kosovës lidhur me luftimin dhe parandalimin e terrorizimit, duke veçuar ndryshimet ligjore për të luftuar dhe parandaluar terrorizmin, si dhe aspektet praktike të ndalimit dhe masave parandaluese si punën në komunitet për parandalimin e këtij fenomeni. Më tej, z. Geci potencoi edhe miratimin nga ana e Qeverisë së Kosovës të „Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit 2015-2020", të miratuar në maj të vitit 2015, si dhe punën në hartimin e planit të zbatimit të kësaj strategjie. Gjate këtij sesioni ishin të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e shteteve te rajonit, të cilët patën mundësinë që të prezantojnë dhe diskutojnë lidhur me sfidat e sigurisë në rajon si dhe terrorizmin dhe luftëtarët e huaj. Një prezantim i veçantë në këtë konferencë është bërë nga dr. Raffi Gregorian- ekspert kundër terrorizmit në Departamentin e Shtetit Amerikan.

Në Brigadën për Reagim të Shpejtë të FSK-së u mbajt trajnimi “Taktikat me Njësi të Vogla"- gjenerata 1/2016

Në kazermën e Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së ,,Ushtarët e NATO-s" në Istog, më 07 prill 2016 u mbajt ceremonia e certifikimit të 39 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët morën pjesë në trajnimin ,,Taktikat me Njësi të Vogla". Në këtë ceremoni të pranishëm ishin: zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrrolli, komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, major Murillo nga Ambasada e SHBA-së në Prishtinë, nënkolonel Ekrem Racaj nga Policia e Kosovës, komandantët e batalioneve të BRSH-së, përfaqësues nga Policia e Kosovës dhe oficerë e nënoficerë të FSK-së. Me këtë rast, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrrolli, duke përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera tha: "Çdo certifikim dhe trajnim është vlerë, kjo vlerë është edhe me e madhe për arsye se në këtë trajnim kanë marrë pjesë edhe pjesëtarë nga Policia e Kosovës. Jam i sigurt se sot ju jeni më të përgatitur dhe mund të kryeni detyrat me profesionalizëm, dhe sigurisht për këto të arritura ndjehem krenar. Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës nuk fillon sot, ne kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm në të gjitha fushat me të gjithë partnerët, me ketë rast, ne jemi duke ndërtuar standarde sidomos me partnerët strategjikë nga ShBA-të dhe këto standarde do t'i kthejmë në vlera, andaj kërkoj nga ju që mos të ndaleni, por të shtyni edhe më tej kufijtë e profesionalizmit dhe vlerave profesionale". Ndërsa komandanti i BRSH-së, koloneli Xhevahir Geci me këtë rast, theksoi "Trajnimi "Taktika me Njësi të Vogla" është i adaptuar nga programi trajnues Pri-Rengjers i Ushtrisë Amerikane, përpos që është një trajnim me karakter ushtarak, gjithashtu është dhe trajnim sfidues i cili ndihmon pjesëtarët tanë që të përgatiten për detyra ku kërkohet sfidë dhe angazhim i lartë për përmbushjen e misionit". Veçanti e kësaj gjenerate është pjesëmarrja e pjesëtarëve të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës e cila e ka pasuruar këtë trajnim duke i dhënë dimension të gjerë këtij trajnimi dhe duke ndihmuar në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërinstitucional. Në fund kolonel Geci i uroi të gjithë pjesëtarët për përfundimin me sukses të trajnimit "Taktikat me Njësi të Vogla', dhe kërkoi nga pjesëtarët që të mirëmbajnë shkathtësitë që përfituan nga ky trajnim dhe që këto njohuri t'i shpërndajnë dhe zhvillojnë në njësitë e tyre, si dhe t'i përdorin ato gjatë trajnimeve dhe ushtrimeve në FSK.



Kurse nënkolonel Racaj nga Policia e Kosovës tha: " Sot jam shumë i privilegjuar që po marr pjesë në këtë ceremoni. Ky trajnim ka qenë sfidë për ju, por njëkohësisht ka shërbyer për të ngritur profesionalizmin tuaj. Për këtë falënderoj shumë FSK-në që na bëri të mundur për të qenë pjesë e këtij trajnimi me pjesëmarrës nga Njësia Speciale e Policisë së Kosovës, dhe jam i bindur se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen". Gjatë këtij trajnimi ndër temat më të veçanta janë trajtuar: Aftësimi i pjesëtarëve në udhëheqje dhe operim me ekipe dhe skuadra si Patrollat, rikonicion, repilim, navigim tokësor i kombinuar ditën dhe natën, prita, reagimi në kontakt, qitja taktike dhe stresuese me armë, operacione urbane dhe tema tjera që janë po ashtu të një rëndësie të veçantë për FSK-në në përgjithësi. Në fund pjesëmarrësve të trajnimit u dhanë certifikata dhe mirënjohje për më të dalluarit dhe instruktorët e këtij trajnimi.

Kontingjenti i KFOR-it slloven mbajti seminar për pjesëtarët e FSK-së


Në Komandën e Forcave Tokësore (KFT) në kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, më 15 prill, u mbajt seminari njëditor me temë: "Menaxhimin e Emergjencave në Sllloveni " nga komandanti dhe rreshter majori i Kontingjentit slloven në Kosovë, si dhe ceremonia e ndarjes së medaljes për rreshter majorin e KFT-së, Fetah Zejnullahun. Në këtë ceremoni të pranishëm ishin komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, shefi i Shtabit i KFT-së, kolonel Naim Haziri, komandanti i Kontingjentit slloven, nënkolonel Bostjan Novak, pjesëtarë nga Zyra për Bashkëpunim Ushtarak (ODC) pranë Ambasadës Amerikanë në Kosovë, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Gjeneral Rama në



fjalën e tij falënderoi shtetin slloven për përkrahjen e vazhdueshme që janë dukë bërë për Kosovën në përgjithësi dhe për institucionin e FSK-së. Ai tha se ,,në veçanti seminari i fundit ka një rëndësi të jashtëzakonshme në menaxhimin e emergjencave, ku pjesëtarët tanë patën mundësinë që të mësojnë nga eksperiencat e Ushtrisë së Sllovenisë në këtë fushë, që të kemi mundësinë të bashkëpunojmë sa më mirë me institucionet tjera në situata të ndryshme të emergjencave". Me rastin e përfundimit të këtij seminari gjeneral Rama ndau mirënjohje në shenjë falënderimi për pjesëtarët që realizuan këtë seminar, ndërsa Ministria e Mbrojtjes së Sllovenisë ndau medalje për "Bashkëpunim Ndërkombëtar" rreshter majorit të KFT-së Fetah Zejnullahut, i cili u shpërblye për punën dhe suksesin e treguar në bashkëpunimin dypalësh. Rreshter major Zejnullahu u shpreh mjaft falënderues dhe i privilegjuar me pranimin e kësaj medalje mjaft domethënëse " Kjo medalje është si rezultat i punës mjaft efikase të lidershipit të FSK-së dhe ushtarëve të cilët i ekzekutojnë detyrat me profesionalizëm të lartë, njëherë kjo medalje më obligon që të punoj edhe më me intensitet në ngritjen profesionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës".

Zyrtarë dhe oficerë të informimit publik kryen trajnimin e programeve për prodhimin e produkteve mediale

Në mjediset e MFSK-së, nën drejtimin e Departamentit për Marrëdhënie me Publikun (DMP), nga 4-8 prill, mbajti trajnimin katër ditor për aftësimin e përdorimit të programeve kompjuterike për prodhimin e produkteve mediale dhe administrimin e mediave sociale. Ky trajnim ishte donacion nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, i realizuar në kuadër të bashkëpunimit shumë të mirë që ekziston në mes Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht në mes dy shteteve tona. Trajnimi u organizua nga kompania ,,Refresh", ku morën pjesë zyrtarë dhe oficerë nga Departamenti për Marrëdhënie me Publikun i MFSK-së dhe Zyra për Informim Publik (ZIP) e Komandës së Forcës Tokësore të FSK-së. Trajnimi kishte për qëllim ofrimin e njohurive dhe zhvillimin e shkathtësive në përdorimin e programeve kompjuterike dhe internetit, zhvillimin dhe menaxhimin e mediave sociale në raport me zhvillimin dhe shpejtësinë e përhapjes së tyre nga përdoruesit gjithnjë e më të shumtë të të gjitha moshave të popullatës së Kosovës. Ky trajnim do të mundësojë rritjen e shpejtësisë së qarkullimit të lajmit dhe informacionit nga momenti i ngjarjes deri te media dhe shfaqja e tij në rrjetet sociale.



FSK-ja dhe ambasada e SHBA-ve i dhurojnë libra fshatit Vitomiricë të Pejës



Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në Prishtinë po ndihmojnë banorët e komuniteteve në Kosovë.

Dje, nënkolonel Afrim Veseli, shef i Sektorit për Bashkëpunim me Agjencitë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) së bashku me zotin AaeronKennedy nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës-Elementi Mbështetës Civilo-Ushtarake në Prishtinë, dhe kryetarin e komunës së Pejës zotin Gazmend Muhaxhiri, vizituan fshatin Vitomiricë të komunës së Pejës, ku u pritën nga përfaqësuesi i komunitetit Boshnjak, zoti Faik Baliq. Me këtë rast, nënkolonel Veseli, z. Kennedy dhe Muhaxhiri bibliotekës së fshatit i dhuruan mbi 403 libra të ndryshëm, që do të jenë në shërbim të banorëve të këtij fshati-të përkatësisë nacionale boshnjake. Këtë gjest e ka përshëndetur zoti Faik Baliq, i cili ka falënderuar FSK-në, Ambasadën e SHBA-ve dhe kryetarin e Pejës, të cilët siç tha Ai, po e ndihmojnë vazhdimisht banorët e komunitetit boshnjak të këtij fshati.

Rreshter majori i FSK-së Genc Metaj nderohet në Akademinë e Rreshter Majorëve në SHBA

Rreshter majori i parë i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Genc Metaj, është shpallur si më i miri i gjeneratës së tij në Akademinë e Rreshter Majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), akademinë më prestigjioze për përgatitjen e udhëheqësve ushtarakë të këtij rangu. Pas analizave dhe sukseseve të rreshter majorëve që kanë kryer këtë akademi, rreshter majori i FSK-së, Genc Metaj, më 13 prill, është nderuar me çmimin më të lartë të gjeneratës dhe automatikisht, Akademia e Rreshter Majorëve e SHBA-së, e ka vendosur fotografinë dhe biografinë e tij në "Dhomën e Famës" (Hall of Fame), së bashku me të gjithë rreshter majorët tjerë të cilët, nga themelimi, kanë kryer shkollimin në këtë institucion. Dhoma e Famës për studentët ndërkombëtarë është mirënjohja më e lartë për arritjet personale dhe për kontributin e dhënë në ngritjen, zhvillimin dhe avancimin e trupës së nënoficerëve" Rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj pas pranimit të këtij çmimi prestigjioz në Akademinë e Rreshter Majorëve u shpreh :"Premtoj se me përkushtim do të vazhdojë punën për avancimin e ushtarëve dhe nënoficerëve të FSK-së dhe shprehi falënderimet e thella për këtë institucion, në të cilin kam ndjekur studimet në vitin akademik 2012-2013". Ai pas pranimit të këtij çmimi, së bashku me Rreshter majorin Rachel Fails nga Garda Kombëtare e Ajovës (Iowa-së), është duke marrë pjesë në simpoziumin për zhvillimin e udhëheqësve dhe trajnuesve ndërkombëtarë, si i ftuar nga Rreshter majori i Ushtrisë Amerikane, Daniel Dailey. Shkollimi dhe trajnimi i oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së në ShBA është vazhdimësi e bashkëpunimit të ndërsjellët në mes të Ushtrisë së ShBA-së dhe FSK-së.



Nëntoger Adison Gara diplomoi në Akademinë Ushtarake Mbretërore „Sundhurts" të Britanisë së Madhe



Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), nëntoger Adison Gara, pas një shkollimi një vjeçar, në një ceremoni ushtarake, më 18 prill 2016, ka diplomuar në Akademinë Mbretërore ,,Sundhurst", të Mbretërisë së Bashkuar. Të pranishëm në ditën e diplomimit ishte zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore (KFT) të Forcës së Sigurisë, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe ambasadori fuqiplotë i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, zoti Lirim Greiçevci. Pas shkollimit një vjeçar në Sandhurst, nëntoger Gara do të kthehet në Kosovë për të vazhduar shërbimin në FSK, me detyrë komandant Toge, në Batalionin e Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSh). Nëntoger Adison Gara është oficeri i dymbëdhjetë me radhë i cili ka diplomuar në Akademinë Mbretërore në Sundhurtst të Britanisë së Madhe. Oficerët e rijnë të FSK-së pas përfundimit të studimeve në Qendrën për Studime Universitare në FSK, sipas marrëveshjes me Britaninë e Madhe vazhdojnë edhe për një vit studimet në Akademinë Mbretërore Ushtarake në Sundhurst të Mbretërisë së Bashkuar. Akademia Ushtarake Mbretërore në Sundhurst të Mbretërisë së Bashkuar është një prej akademive prestigjioze në Britani si dhe në mbarë botën prej së cilës kanë dalë ushtarakë të cilët kanë lënë gjurmë në këtë lëmi.

FSK-ja me aktivitete të shumta shënoi Ditën Ndërkombëtare të Tokës

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës, më 22 prill, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe FSK-ja organizuan aktivitete të ndryshme si pastrimin e hapësirave të gjelbra, mbjelljen e fidanëve-drurëve dekorativ dhe luleve, në mjediset e Ministrisë dhe kazermave të FSK-së, si dhe pastrimin e disa hapësirave publike. Aktiviteti kryesor u mbajt në mjediset e MFSK-së dhe në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, ku morën pjesë: zëvendësministrat Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, gjeneralët Zymer Halimi, Nazmi Brahimaj dhe Gëzim Hazrolli, oficerë dhe ushtarë të FSK-së, si dhe safi civil i Ministrisë. Aksionin për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës e përshëndeti zëvendësministri Fadil Gashi i cili falënderoi të gjithë pjesëmarrësit të cilët pastruan mjediset përreth Ministrisë dhe FSK-së. Ai njëherësh kërkoi nga të pranishmit që për mjedisin të kujdesemi çdo ditë, në mënyrë që të rrisim kualitetin e jetës në mjediset ku jetojmë dhe punojmë. Ky aksion u shënua në të gjitha kazermat e FSK-së. Aksionit për pastrimin dhe mbjelljen e fidanëve në Ministri dhe FSK iu bashkuan edhe pjesëtarët e NAT-it, NLAT-it (Ekipi Këshillues dhe Ekipi Ndërlidhës i NATO-s për FSK-në). Po ashtu në kuadër të bashkëpunimit Civilo-Ushtarak, FSK-ja me rastin e Ditës së Tokës ka qenë e angazhuar me mjetet teknike dhe personel në pastrimin e hapësirave në lagjet ,,Emshir" dhe "Hajvali", ku në Hajvali ka pastruar mjediset e gjelbra përreth Pallatit të Drejtësisë .



Certifikohen pjesëtarët e Kompanisë së Komunikimit për pajisjet e rrjetit strategjik-Harris

Në Kompaninë e Komunikimit në kazermën „Adem Jashari", në Prishtinë, më 01 prill 2016, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të cilët përfunduan trajnimin "Pajisjet e rrjetit strategjik-Harris". Në këtë ceremoni të pranishëm ishin zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i Zyrës së Komunikimit në KFT, nënkolonel Gyrner Murati, major Nexhmi Ahmeti nga Departamenti për Komunikim në MFSK si dhe komandanti i Kompanisë së Komunikimit, kapiten Fatmir Kajtazi. Më këtë rast zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral Hazrolli pasi përshëndeti të gjithë ata që mundësuan realizimin e këtij trajnimi, foli për rëndësinë e fushës së Komunikimit në FSK, ku ndër të tjera tha: "Komunikimi është dhe do të jetë edhe në të ardhmen një fushë me rendësi të veçantë për FSK-në. Ne e kemi përzgjedhur ,, Harris-in" si pajisje strategjike në FSK, dhe në kontest të saj, ne duhet të tentojnë të jemi të ndërveprueshëm edhe me institucione tjera në Kosove dhe me partnerët strategjikë. Duhet të familjarizoheni me pajisjen dhe ta dini rëndësinë e kësaj fushe dhe rëndësinë e juaj dhe të detyrës që jeni duke kryer. Mirëmbajtja dhe përdorimi i mirë i pajisjes është mbi të gjitha" theksoi gjeneral Gëzim Hazrolli. Ai, gjatë fjalës së tij, në veçanti përshëndeti përfaqësuesin e HARRIS-it, i cili ishte i pranishëm në këtë ceremoni, për kontributin e tij gjatë trajnimit në fushën e komunikimit. Ndërsa, komandanti i Kompanisë së Komunikimit, kapiten Fatmir Kajtazi u shpreh mjaft i kënaqur më realizimin e këtij trajnimi dhe me interesimin që treguan pjesëmarrësit gjatë trajnimit. Ai nder tjera shtoi "Gjatë këtyre tri javëve pjesëtarët tanë patën mundësinë që të aftësohen edhe më tej në këtë fushë. Ne jemi munduar që pjesëmarrësit e trajnimit t'i aftësojmë jo vetëm në përdorimin e Harris-it, por edhe në përdorimin dhe ndërlidhjen e pajisjeve tjera të cilët i posedon Kompania e Komunikimi". Kapiten Kajtazi tha gjithashtu se "Ky certifikim është vetëm hapi i parë, pasi që rezultati i këtij trajnimi do të shihet gjatë punës dhe veprimeve tuaja në ushtrimet fushore të cilat realizohen në FSK". Trajnim për "Pajisjet e rrjetit strategjik-Harris" u realizua nga instruktorët amerikanë nga datat 14.03.2016 deri më 01.04.2016, ku kanë marrë pjesë 10 pjesëtarë. Kjo fazë e trajnimit ka qenë e fokusuar në çështje teorike, si dhe në instalime dhe montime të pajisjeve nëpër pikat ritransmetuese sipas projektit të rrjetit strategjik.



FSK-ja realizoi ushtrimin fushor të koduar "Veprimi i Shpejtë-07"



Në kazermën "Minatori" të Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së dhe në Fabrikën e Akumulatorëve të Kombinatit Trepça u mbajt ushtrimi fushor „Veprimi i Shpejtë-07", realizuar nga pjesëtarët e Kompanisë 3A të Batalionit të 3-të, të NJNRK-së, Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) dhe Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) me njësi. Ushtrimi „Veprimi i Shpejtë-07" ka filluar të realizohet më 11 janar 2016, në kuadër të përmbylljes së fazës së parë dhe ka përfunduar më 7 prill 2016. Pjesëmarrës në këtë ushtrim ishin edhe përfaqësues të institucioneve të tjera nga regjioni i Mitrovicës, si nga Policia e Kosovë, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Departamenti Shëndetësor, Kryqi i Kuç, Brigada e Zjarrfikësve, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, Klubi i Zhytjes „Trepça" etj. Për të përcjellë nga afër ushtrim fushor "Veprim i Shpejtë 07" të pranishëm ishin zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s, për FSK-në (NLAT), gjeneral brigade Ernest Horn, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, zëvendësdrejtoresha e Policisë Rajonale të Mitrovicës, nënkolonel Afërdita Mikullovci, komandanti i Batalionit të Tretë, major Beton Ratkoceri dhe oficerë dhe nënoficerë të lartë të FSK-së, Policisë së Kosovës dhe të KFOR-it. Me rastin e përfundimit të këtij ushtrimi para të pranishmëve u mbajt një takim i shkurtër ku ata u njoftuan për mbarëvajtjen e këtij ushtrimi, për rolin dhe rëndësinë e tij. Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, vlerësoi lart procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor „Veprimi i Shpejtë-07" si dhe koordinimin ndërmjet agjencive civile dhe BAT 3-të BRSH-së. Sinqerisht duhet të ndjeheni mirë secili prej jush që ka marr pjesë në ekzekutimin e këtyre operacioneve dhe ushtrimit në përgjithësi. Dua t'ju përgëzoj për punën që e keni bërë që ky ushtrim të jetë i suksesshëm. Ne perfekt na bënë vetëm stërvitja me objektiva të qarta, me zbatim të misionit, e misioni i gjithë këtyre institucioneve së bashku me mysafirët tanë ndërkombëtarë, është që të krijojmë një ambient të sigurt, siguri për të gjithë njerëzit dhe ambientit në Republikën e Kosovës ". Gjatë realizimit të këtij ushtrimi u ekzekutuan gjithsej nëntë (9) operacione të ndryshme si: Menaxhimi i turmave, zjarr urban, evakuimi me shkallë, trajtim mjekësor, kërkim-shpëtim me litar, zonë e minuar, zonë e kontaminuar si dhe operacione urbane. Ky ushtrim vjen në kuadër të planit vjetor të trajnimeve dhe aktiviteteve të Batalionit të 3-të, ku qëllimi i ushtrimit është mbajtja e nivelit të gatishmërisë së pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe bashkëpunimi me agjencitë tjera në zonën e përgjegjësisë së Batalionit të Tretë.

Brigada për Reagim të Shpejtë mbajti ushtrimin fushor të koduar „Ujku 1B godet"



Në zonën e përgjegjësisë të Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSh) të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), më 6 prill, në Gjilan u mbajt ushtrimi fushor treditor i koduar me emrin „Ujku 1B godet" të cilin e realizuan pjesëtarët e Kompanisë 1B të këtij Batalioni. Ushtrimin fushor të Batalionit të Parë të BRSH-së, nga afër e përcolli edhe drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës i NATO-s për FSK-në (NLAT), gjeneral brigade Ernest Horn, komandanti i Batalionit të Parë, nënkolonel Haki Xhemajli si dhe oficerë të KFOR-it dhe të FSK-së. Nënkolonel Haki Xhemajli, komandanti i Batalionit të Parë, e falënderoi drejtorin e NLAT-it, gjeneralin Horn, për kohën që ka ndarë dhe për gatishmërinë që ka treguar për të marrë pjesë në këtë ushtrim. Nënkoloneli Xhemajli, më tej e njoftoi gjeneralin Horn lidhur me qëllimin dhe rrjedhën e këtij ushtrimi, si dhe për aktivitet e ndryshme të cilat janë duke u realizuar në këtë batalion. Ndërsa gjenerali Horn i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së që realizuan këtë ushtrim, duke kërkuar nga ta që edhe në të ardhmen të vazhdohet me trajnime të tilla dhe më të avancuara, të cilat do ndihmojnë FSK-në. Ushtrimi fushor "Ujku 1B " është përmbyllje e fazës tremujore të trajnimeve, bazuar në Listën e detyrave esenciale për zbatimin e misionit dhe planit vjetor të aktiviteteve të Batalionit të Parë të Reagimit të Shpejtë.

Dhe ushtrimin fushor „Panteri 1"



Kompania 2C e Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, sipas planit vjetor të stërvitjes, nga data 11 janar 2016 e deri më 13 prill 2016, realizoi me sukses trajnimin e brendshëm tremujor të gjenerimit të forcës. Kompania 2C e finalizoi trajnimin tremujor me ushtrimin fushor të koduar "Panteri 1" (72 orësh), në fshatin Lumbardh të Komunës së Deçanit e që është zonë e përgjegjësisë së Batalionit të Dytë. Ky trajnim është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Dytë dhe është zbatuar në nivel Kompanie, si dhe është mbështetur dhe vlerësuar nga Komanda e Batalionit të Dytë dhe nga vëzhguesit e Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) dhe të Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO). Ushtrimin fushor ‚Panteri 1", nga afër e kanë përcjellë edhe komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në (NLAT), gjeneral brigade Ernest Horn, komandanti i Batalionit të Dytë, nënkolonel Mehmet Lladrovci, si dhe oficerë të lartë të FSK-së. Ky ushtrim ishte pjesë përbërëse e ushtrimeve në kuadër të ciklit të gjenerimit të forcës, ku pjesëtarët e këtyre njësiteve sfidohen fizikisht me patrullime natën dhe ditën, lëvizjet taktike me autoblinda, vetëmbrojtje, navigim tokësor, marrshim taktik, operacione urbane, rikonicion, okupimi i bazës patrulluese dhe tema tjera ushtarake. Pjesëtarët e Kompanisë 2C, gjatë trajnimit, treguan vendosmëri dhe moral të lartë për realizimin e misionit. Çdo detaj ka funksionuar në bazë të Procedurës së Udhëheqjes së Trupave. Në fund, komandanti i BRSH-së kolonel Geci dhe drejtori i NLAT-it gjenerali Horn vlerësuan lartë performancën e pjesëtarëve të Kompanisë 2C të Batalionit të Dytë, dhe njëherësh i përgëzuan ata për angazhimin dhe profesionalizimin e treguar gjatë realizimit të ushtrimit fushor „Panteri 1".

U varros me nderime të larta kapteri i FSK-së Hiser Muja

Me nderime të larta ushtarake, më 24 prill, u varros në varrezat e qytetit të Prizrenit, ish luftëtari i lirisë dhe pjesëtari i FSK-së, Hiser Muja. Për t'i dhënë lamtumirën e fundit pjesëtarit të FSK-së ishin edhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve në MFSK, gjeneral brigade Gzim Hazrolli zëvendës komandant i Komandës së Forcës Tokësore të FSK-së, si dhe shumë ushtarë, oficerë dhe zyrtarë të FSK-së dhe MFSK-së. Në emër të FSK-së, nga i ndjeri është ndarë zv/komandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Irfete Spahiu, e cila tha se ndarja e parakohshme nga jeta e Hiser Mujës, është humbje e jashtëzakonshme për familjen, për Forcën e Sigurisë së Kosovës, por edhe më gjerë. Është humbje për të gjithë ne që e kemi njohur, për miqtë e tij të shumtë, për të gjithë ata që kanë vepruar dhe punuar me të". Ndërsa, komandanti i KDS-së, Enver Cikaqi, në telegramin e tij dërguar nga Londra u shpreh: "Çdo ndarje nga shokët e armës është e dhimbshme por kur kjo ndarje vjen herët në moshë, si kjo e Hiserit, dhimbja është e dyfishtë. Ne, sot po ndahemi nga një shokë i yni me virtyte të larta. Prizreni po ndahet nga një qytetarë që i ka dhënë çdo herë ndihmë e përkrahje, ndërsa Kosova po ndahet nga një Luftëtarë Lirie, ndërtues e ruajtës i paqes që përkundër sfidave i qëndrojë besnik betimit për të mbajtur uniformën e vendit tonë për 18 vite me radhë".Kurse Isa Berisha kryetar i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së në Prizren në fjalën e tij, me kë këtë rast, ndër të tjera tha: "Me daljen e UÇK-së në rajonin e Vrrinit fillimisht Hiseri kyqet në lagjen e Trimave në Tusus ku shquhej për trimëri dhe urtësi. Ai



ishte gjithmonë në ballë të çdo organizimi që e kërkonte UÇK-ja, pra me një fjalë ai kryente të gjitha urdhrat dhe detyrat të cilat iu kishin ngarkuar nga komandantët. Duhet të theksoj se ishte edhe vetë pjesëmarrës i shumë ofensivave që ndodhën në rajonin e Vrrinit, po ashtu ai e kishte marrë rrugën disa here për t'u furnizuar me armatim në Shqipëri". Në emër të familjes ka folur Melit Muja, i cili ka falënderuar të gjithë ata që në këto çaste të dhimbjes po qëndrojnë afër familjes së të ndjerit, veprat e të cilit do të jetojnë gjithmonë me ne, theksoi ai.

FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 47 • Qershor 2016 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Kongresi Amerikan përkrah Kosovën në Programin e Partneritetit për Paqe

Ministri i FSK-së, z. HakiDemolli së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama, më 19 maj 2016, pritën në një takim pune ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), z. GregDelawie. Fillimisht, ministri Demolli falënderoi ambasadorin Dellawie për ndihmën e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin për ngritjen profesionale të FSK-së, siç është bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Ajovës. Një falënderim të veçantë ministri Demolli i shprehu ambasadorit Delawie, lidhur me kërkesën e Kongresit Amerikan që të fillojnë përgatitjet që Kosova të hyjë në Programin e Partneritetit për Paqe (PfP), në kuadër të NATO-s. Gjatë takimit, ministri Demolli dhe ambasadori Delawie biseduan edhe për zhvillimet e përgjithshme në Ministri, me theks të veçantë rreth procesit të transformimit të FSK-së. Me këtë rast, ambasadori Delawie tha se; ,,Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë ta përkrahin procesin e transformimit të FSK-së". Gjithashtu, ambasadori Delawie shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të deritashëm në mes dy shteteve, si dhe bashkëpunimin e FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ai premtoi vazhdimin e bashkëpunimit dhe ndihmën e pakursyer edhe në të ardhmen



për ta ndihmuar Forcën e Sigurisë së Kosovës drejt profesionalizimit të saj. Në takim morën pjesë edhe shefi i kabinetit të ministrit, z. Latif Leka, atasheu i Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-ve, në Kosovë, koloneli Anthony Butts dhe Michael Polyak.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s në Romë



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, nga data 09-13 maj 2016, mori pjesë në kursin e lartë "Generals, Flag Officersand Ambassadors' Course", i cili u mbajt në Kolegjin e Mbrojtjes në Romë. Qëllimi i këtij kursi ishte njoftimi rreth çështjeve aktuale politiko-ushtarake dhe shqetësimet që ndikojnë në Aleancë, si dhe për të rritur mirëkuptimin e ndërsjellë dhe për të promovuar rrjetin e bashkëpunimit mes gjeneralëve pjesëmarrës, oficerëve të lartë, ambasadorëve dhe civilëve me grada ekuivalente. Programi i përgjithshëm i kursit i është dedikuar analizës dhe diskutimit të çështjeve kyçe dhe sfidave me të cilat përballet aktualisht Aleanca dhe si i zbaton NATO-ja rekomandimet nga Samiti i Uellsit dhe ai i Chicagos; Konceptin Strategjik të vitit 2010; rolin e saj operacional në Afganistan, në kuadër të misionit të Rezolutës për Mbështetje; si i monitoron nga afër zhvillimet në Ukrainë, Irak dhe Siri; si dhe përgatitjet për Samitin e ardhshëm të NATO-s në Varshavë. Kursi ishte i fokusuar në atë se si këto tema të nivelit strategjik do të formësojnë mjedisin e ardhshëm politik dhe strategjik, si dhe ndikimin e këtyre në NATO dhe tek politik-bërësit ushtarakë dhe civilë që kanë të bëjnë me NATO-n. Qasja teorike është siguruar nga akademikë, praktikues dhe diplomatë me përvojë. Pjesëmarrësit e kursit kanë përfituar nga sesionet pyetje-përgjigje dhe nga qasja e lirë e politikës akademike për të shfrytëzuar potencialin e plotë të ligjëruesve. Diskutimet brenda Komitetit, nganjëherë ligjëruesit mikpritës inkurajuan shkëmbimin e pikëpamjeve ndërmjet pjesëmarrësve të kursit, në mënyrë që të zhvillojnë të kuptuarit e përbashkët të temave të ndryshme. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama gjatë këtij kursi të NATO-s, zhvilloi takime me gjeneralë dhe pjesëmarrës të tjerë, ku i njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, njëherësh i falënderoi edhe për ndihmën e vazhdueshme që ata po japin për FSK-në.

Togerja e FSK-së Manushaqe Nura e para në Garën Ndërkombëtare të mbajtur në Republikën e Kroacisë

Në poligonin ushtarak "Gjakovo" në Grubisnjo-Polje të Kroacisë, më 11-12 maj 2016, u mbajt ceremonia zyrtare për shpalljen e ushtarit më të mirë për vitin 2016.Gara për përzgjedhjen e ushtarit më të mirë, që mbahet çdo vit në Kroaci, është njëra ndër garat ushtarake më të forta në Botë. Në këtë garë kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 15 shteteve të NATO-s, si dhe shumë përfaqësues të shteteve partnere të Kroacisë. FSK-ja në këtë garë është përfaqësuar nga tre pjesëtarë: Toger Manushaqe Nura dhe tetarët; Binak Podrimçaku dhe Feti Pronaj. Në garën për përzgjedhjen e ushtarit më të mirë në nivel ndërkombëtar, kanë marrë pjesë 145 ushtarë, të cilët kanë marshuar 40 kilometra me 17.6 kilogram ngarkesë në shpinë, duke kaluar-ekzekutuar 13 detyra ushtarake. Pjesëmarrësit nga Kroacia kanë garuar për zgjedhjen e ushtarit më të mirë të Kroacisë, ndërsa pjesëmarrësit nga shtetet e NATO-s dhe ato partnere kanë garuar për zgjedhjen e ushtarit më të mirë ndërkombëtar, për të dy gjinitë. Edhe kësaj here, në këtë garë, FSK-ja u dallua për paraqitjen e saj të shkëlqyeshme, duke dëshmuar përgatitje të lartë profesionale, krahas pjesëmarrësve të tjerë të shteteve të NATO-s. Kështu, në



konkurrencën e femrave, toger Manushaqe Nura zuri vendin e parë dhe është nderuar me medalje, ndërsa në konkurrencën, mjaft të fortë të meshkujve, në nivel ndërkombëtar, tetari Binak Podrimqaku zuri vendin e tretë, ndërsa tetari Feti Pronaj të 13-tin.Për FSK-në dhe Kosovën në përgjithësi, ky është një sukses jashtëzakonisht i madh, kur kemi parasysh konkurrencën e fortë të pjesëmarrësve ndërkombëtarë. Kjo dëshmoi edhe një herë barazinë profesionale të FSK-së me ushtritë pjesëmarrëse në përzgjedhjen e ushtarit më të mirë në Kroaci, për vitin 2016.

Ministri i FSK-së, HakiDemolli takoi ambasadorin e Zvicrës në NATO

Më 25 maj 2016, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. HakiDemolli priti në një takim zyrtar ambasadorin e Zvicrës në NATO, në Bruksel, z. ChristianMeuwly i cili së bashku me ambasadoren e Zvicrës në Kosovë, znj. KrystynaMartyLang, kryesonin delegacionin nga Zvicra. Ministri Demolli falënderoi ambasadorin e Zvicrës në NATO, z. Meuwly, për ndihmën e vazhdueshme që Qeveria e Zvicrës ka dhënë për Kosovën dhe në kuadër të saj edhe për FSK-në, si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që kanë dy shtetet në të gjitha fushat. Ministri Demolli, me këtë rast, e ka njoftuar ambasadorin Meuwly me të arriturat e përgjithshme të FSK-së; zhvillimet aktuale, për procesin e transformimit të FSK-së, ku ka qenë i angazhuar DIRI (Iniciativë e rishikimit të Institucioneve të Mbrojtjes) nga SHBA-të, pastaj Ekipet Këshilluese të NATO-s, në MFSK, Ekipet Këshilluese Ndërlidhëse të NATO-s, në FSK dhe partnerë të tjerë ndërkombëtar. Gjithashtu, ministri Demolli, bisedoi edhe për letrën që kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Isa Mustafa, i ka dërguar NATO-s, për mbështetjen e saj, për transformimin e FSK-së dhe avancimin e mëtutjeshëm të partneritetit të Kosovës me NATO-n. Në Fjalën e tij, ministri Demolli siguroi mysafirët nga Zvicra se Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK) nuk do të përbëjë kërcënim për fqinjët. Ajo do të jetë Forcë që synon anëtarësimin në NATO, Forcë që një ditë do të jetë pjesë e misioneve paqësore kudo që e kërkon nevoja. Ndërsa, ambasadori i Zvicrës në Selinë e NATO-s, në Bruksel, z. Meuwly shprehi kënaqësinë e tij, për pritjen në Ministrinë e FSK-së, si dhe premtoi për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Ai tha se Zvicra ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe do të vazhdojë të përkrah Kosovën në integrimet Euro-Atlantike. Në takim morën pjesë edhe shefi i kabinetit të ministrit Latif Leka dhe drejtori i Ekipi Këshillues të NATO-s, në MFSK, z.DominicBraithawaite



Ministri Demolli priti një delegacion të Parlamentit të Mbretërisë së Suedisë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), HakiDemolli, më 31 maj, priti një delegacion të deputetëve të Parlamentit të Mbretërisë së Suedisë të kryesuar nga deputeti BjornVonSydow, kryesues i delegacionit të Suedisë në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, të shoqëruar nga ambasadori i Suedisë në Kosovë, MatsStaffanson. Në takimin e përbashkët të dyja delegacioneve morën pjesë edhe zëvendës ministrat: Fadil Gashi dhe MuhametLatifi, shefi i Drejtorisë së Operacioneve gjeneral brigade ZymerHalimi, këshilltari ushtarak i Ministrit, kolonel Fadil Hadergjonaj dhe shefi i kabinetit të Ministrit, Latif Leka.



Ministri Demolli fillimisht falënderoi delegacionin e Parlamentit të Suedisë për mbështetjen dhe përkrahjen që Suedia ka dhënë për Kosovën e në veçanti në fushën e sigurisë duke vlerësuar kontributin e kontingjentit ushtarak suedez në kuadër të KFOR-it. Ministri Demolli vlerësoi lartë përkrahjen dhënë FSK-së, në fushën e kërkimshpëtimit dhe deminimit, njësi këto të specializuara të FSK-së, për të cilat Suedia ka kontribuar mjaft shumë. Më pas, ministri Demolli i njoftoj të delegacionin e Suedisë, për misionin dhe zhvillimin e FSK-së, marrëdhëniet me vendet e regjionit, me vendet e NATO-s dhe ato që aspirojnë në NATO, duke u ndalur me theks të veçantë në çështjen e planifikimit për implementimin e rekomandimeve të dala nga Rishikimi i Strategjisë së Sektorit të Sigurisë të Kosovës.
Gjithashtu, ministri Demolli deklaroi se: Procesi i transformimit të FSK-së në FAK, do të jetë plotësisht transparent, dhe ne jemi duke punuar që kjo të ndodhë në mënyrë që përgatitjet e Forcës për transformim t'i implementojmë sipas fazave të parapara. Me këtë rast, ministri Demolli theksoi faktin se qeveria ka marrë zotimin se do të bëjë financimin e tërë procesit të transformimit dhe zhvillimit të saj. Mysafirët nga Suedia, ministri Demolli i siguroi se ashtu si FSK-ja edhe Forcat e Armatosura të Kosovës do të jenë në shërbim të popullatës shumicë dhe komuniteteve pakicë si dhe do të ketë përfaqësim gjinor në përputhje me standardet e NATO-s. Gjatë takimit, ministri Demolli kërkoi që të fillohen përgatitjet për inicimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të dy ministrive. Po ashtu ai kërkoi nga Suedia që të mbështes arritjen e statusit të Partneritetit për Paqe me NATO-n.
Delegacioni nga Suedia shprehi gatishmërinë që të përkrah Kosovën dhe FSK-në në procesin e transformimit, si dhe të thellojë edhe më tej bashkëpunimin në fushën e sigurisë. Nga pjesëtarët e delegacionit u bënë pyetje të ndryshme nga fusha e sigurisë, të cilët ishin mirë të informuar për gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe më gjerë, me vetë faktin se pjesë e delegacionit ishin edhe dy ishministra të mbrojtjes.

Studentë të Kolegjit Mbretëror për Studime të Sigurisë së Mbrojtjes vizitë në Ministrinë për FSK-në

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK) më 31 maj qëndroi për një vizitë zyrtare një delegacion i studentëve të Kolegjit Mbretëror për Studime të Sigurisë me seli në Londër, të Mbretërisë së Bashkuar. Delegacioni shoqërohej nga atasheu i Mbrojtjes i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Maqedonisë dhe i akredituar edhe në Republikën e Kosovës, nënkolonel RichardPerry dhe përfaqësues të ambasadës së Britanisë së Madhe në Prishtinë. Ata u pritën nga ministri HakiDemolli, ministrit i Punëve të Brendshme Skënder Hyseni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama, zëvendës komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli i cili gjatë vitit 2015, kreu studimet një vjeçare në këtë Akademi. Me këtë rast, ministri i FSK-së, HakiDemolli i njoftoi oficerët dhe zyrtarët e Kolegjit Mbretëror për misionin, strukturën, kapacitetet, aktivitetet dhe planet e Ministrisë për zhvillimin dhe transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.
Ai, gjithashtu i njoftoi të pranishmit për marrëdhëniet e FSK-së, me vendet e regjionit si dhe me vendet e NATO-s dhe ato që aspirojnë në NATO, duke u ndalur me theks të veçantë në çështjen e planifikimit për implementimin e rekomandimeve të dala nga Rishikimi i Strategjisë së Sektorit të Sigurisë të Kosovës. Duke iu përgjigjur pyetjeve të pranishmëve, ministri Demolli deklaroi se: Procesi i transformimit të FSK-së në FAK do të jetë plotësisht transparent dhe ne jemi duke punuar që kjo të ndodhë, në mënyrë që përgatitjet e Forcës për transformim t'i implementojmë sipas fazave të parapara. Ministri Demolli tha se, ashtu si FSK-ja edhe Forcat e Armatosura të Kosovës do të jetë në shërbim të popullatës shumicë dhe komuniteteve pakicë e gjithashtu do të ketë përfaqësim gjinor në përputhje me standardet e NATO-s. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama u përgjigje në disa çështje për të cilat ushtarakët e Kolegjit i parashtruan, si për çështje të sigurisë, operacioneve, zhvillimit të trupës së oficerëve. Gjeneral Rama për çështje të Sigurisë, tha se kemi shkëmbime informacioneve me partnerët si KFOR-in, dhe institucione tjera vendore e nëpërmjet tyre edhe me vendet fqinje. Ai, u ndal te shkollimi i oficerëve nga radhët e komuniteteve, ku veçoi diplomimin e oficerëve të parë nga radhët e komunitetit serb, të cilët këtë vit dalin në detyrë si nëntoger, pas një shkollimi katër vjeçar në Akademinë e Mbrojtjes në Republikën e Maqedonisë. Një prezantim të shkurtër për gjendjen e sigurisë në vend, sfidat dhe kërcënimet e përgjithshme që ballafaqohet Kosova e paraqiti, ministri i Punëve të Brendshme SkenderHyseni. Zoti Hyseni tha se Kosova në këto zhvillime, nuk përbën përjashtim duke folur për masat që ka marrë Qeveria e vendit në drejtim të parandalimit të rekrutimit të qytetarëve të Kosovës, për të marrë pjesë në luftërat e huaja, pastaj për migrimin e popullatës vendore drejt perëndimit si dhe refugjatët nga Lindja e Mesme, gjithashtu edhe për trafikimin e lëndëve narkotike e dukuri tjera negative. Kolegji Mbretëror i Studimeve të Mbrojtjes në Mbretërinë e bashkuar është themeluar në vitin 1927 dhe ofron edukim strategjik të oficerëve të Forcave të Armatosura dhe nëpunësve civilë ekuivalente të cilët kanë potencial për të arritur gradat më të larta si dhe ata që punojnë dhe do të punojnë në nivel strategjik.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri i FSK-së Haki Demolli takoi të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Hungarisë z. Bela Bozsik

Ministri i FSK-së, z. HakiDemolli më 19 maj 2016, takoi të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Republikës së Hungarisë në Prishtinë, z. Bela Bozsik. Me këtë rast, ministri Demolli e njoftoi z. Bozsik, me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe lidhur me bashkëpunim ndërkombëtar dhe rajonal që ka FSK-ja. Gjatë takimit, ministri Demolli theksoi bashkëpunimin e mirë që ka Kosova me Hungarinë, veçanërisht ai vlerësoi thellimin e bashkëpunimit të MFSK/FSK-së, me Ushtrinë e Hungarisë. Temë e veçantë e takimit të sotëm ishte vizita zyrtare e Ministrit Demolli dhe delegacionit të FSK-së, në fillim të qershorit, në Republikën e Hungarisë, si dhe përgatitjet që po bëhen për nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të dy Ministrive; Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Nga ana e tij, i ngarkuari me punë në Ambasadën e Hungarisë në Kosovë, z. Borzsik shprehi mirënjohje për pritjen që iu bë nga ministri Demolli. Ai gjithashtu premtoi se Hungaria do ta ndihmojë FSK-në, në të gjitha fushat që janë me interes për të dyja palët. Në takim morën pjesë edhe shefi i Kabinetit të Ministrit, Latif Leka dhe sekretari i parë i Ambasadës së Hungarisë në Kosovë, ImreVekas-Kovacs.



Forca e Sigurisë se Kosovës i bashkohet Skuadriljes me ngjyra luftarake për zgjidhjen e Kombinuar

(HOHENFELS, Gjermani) - Ushtarët nga Forca e Sigurisë së Kosovës ju bashkuan skuadriljes së 5-të, të Regjimentit të 7-të të Kalorësisë për zgjidhjen e kombinuar të ushtrimit VI-të, në Hohenfel-Gjermani, nga data 5-25 maj. Zgjidhja e kombinuar VI-të është një rotacion veprues vendimmarrës në nivel skuadriljes në Qendrën e Përbashkët Shumëkombëshe për gatishmëri e ndërtuar për të trajnuar forcat e ushtrisë amerikane të angazhuara ne rajon tek Komanda Amerikane për Evropë. Nënkoloneli ChristopherMahaffey, komandanti i skuadriljes së 5-të, të Regjimenti 7-të të kalorësisë tha, që ushtaret nga Kosova shumë shpejt janë integruar në stafin e skuadriljes. "Ju kemi thënë të përvjelin mëngët dhe të vijnë këtu dhe të përlyejnë duart ", tha Mahaffey. "Ata me të vërtet janë përfshirë në këtë dhe kanë mësuar së bashku me ne, ku është shumëfishuar forca me prezencën e tyre këtu". Kapiten Korab Dauti, oficer inteligjence i Forcë së Sigurisë së Kosovës, më herët ka marr pjesë në Kursin bazik të oficereve lider të inteligjencës ushtarake amerikane. Ajo përvojë ka ndihmuar at të punojë përkrah oficerëve për inteligjencë të skuadriljes, gjithashtu duke ofruar edhe perspektiva të reja. "Ishim në të njëjtat frekuenca" tha Dauti. Të dyja palët e dinim se çfarë qëllimesh kishim për t'i arritur ato. Jam përpjekur të ofroj mënyrën tonë të qasjes dhe një perspektive tjetër për qëllimin e njëjtë. Kapiten Vegim Krelani, oficer këmbësorie në Forcën e Sigurisë së Kosovës tha që sfida më e madhe gjatë punës në operacione të skuadriljes ishte puna me njësitin e mjeteve të blinduara, për herë të parë. "Jam duke mësuar për përbërjen e tyre, si operojnë, dhe më e rëndësishmja si të mbajmë të gjitha këto automjete, për të cilat nuk kemi nevojë të mendojmë në situata tjera tha Krelani. Mahaffey tha, që ardhja e pjesëtarëve të mençur dhe me përvojë ishte një shumëzues i rëndësishëm i forcës ". Më ka informuar shkurtimisht një kosovar për terrenin dhe motin dje, si pjesë e shopit s-2, tha Mahaffey. " shumë mirë; djaloshi ishte profesional. Këtu e kemi një që është i diplomuar i kursit të karrierës së kapitenit të manovrës nga SHBA, dhe ai është si ta kesh planifikuesin e dytë me vete. Një dallim që si Krelani po ashtu edhe Dauti vërejtën mes stafit të SHBA-ve dhe kosovareve është numri i nënoficerëve "Stafi i SHBA-ve janë më të plotësuar dhe kanë më shumë NOF" tha Krelani. "Këtu kemi mundësin të shohim marrëdhënien oficer dhe nënoficerë dhe njerëzve duke punuar si ekip njëkohësisht në kryerjen e shumë gjërave në mënyrë që objektivat të jenë të mira. Mësimet e mësuara për palën kosovare dhe ushtaret e SHBA-ve, jo vetëm që i ndihmojnë ata përgjatë gjithë Zgjedhjes së Kombinuar, por gjithashtu i bënë ata më ndërveprues kur të punojnë së bashku në të ardhmen. "Jam shumë i gëzuar që ne si kontingjent i FSK-së, të marrim pjesë në këtë ushtrim dhe të mësojmë për homologet tanë në kal 5-7, kështu që nëse vjen mundësia të punojmë në operacione reale në të ardhmen, ne do të jemi të sinkronizuar" tha Dauti.



Shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel NaimHaziri mori pjesë në ushtrimin ,,Combined/JointWarGame"në Republikën e Turqisë

Me ftesë të komandantit të Kolegjit Ushtarak të Luftës në Republikën e Turqisë, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel NaimHaziri, më 20 maj 2016, së bashku me komandantin e Batalionit të tretë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë, major Beton Retkoceri dhe atasheu i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Turqi, nënkoloneli Bekim Osmani kanë përcjellë ushtrimin fushor të koduar "Combined/JointWar Game" me pjesëmarrjen e 600 ushtarakëve nga kolegjet ushtarake të Forcave Tokësore, Forcave Ajrore dhe Forcave Detare.Pjesë e këtij ushtrimi ishin edhe dy oficerë të FSK-së, të cilët janë duke i ndjekur studimet në ,,Kolegjin e Luftës " në këtë Akademi: majori Lulzim Deliu dhe kapiteni Bastri Topalli. Qëllimi i ushtrimit ishte vlerësimi i nivelit të aftësive të studentëve dhe pjesëmarrësve lidhur me procesin e planifikimit operacional, zhvillimi i aftësive të pjesëmarrësve për qasje gjithëpërfshirëse, bashkëpunimi dhe koordinimi ushtarak me qeverinë, institucionet joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare. Për të



eksperimentuar strukturë të përbashkët dhe taktike me selinë e Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare. Oficerët e lartë të FSK-së, janë ftuar të përcjellin nga afër këtë ushtrim në Vendkomandë së bashku me përfaqësuesit e 35 shteteve të botës. Shefi i Shtabit të KFT-së e ka takuar komandantin e akademive ushtarake turke, gjenerallejtënant TahirBakiroglun, të cilin e ka falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme që është duke dhënë Ushtria Turke, për përgatitjen e ushtarakëve nga Kosova. Ai gjithashtu është takuar edhe me komandantin e Kolegjit të Luftës, gjeneralmajor SelimMert, me të cilin kanë biseduar me zhvillimet si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në mes FSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë.

FSK-ja në konferencën ndërkombëtare "10th Annual SEANCO" në Rumani

Në Sibiu të Rumanisë, më 19 maj, ka përmbyllur punimet treditore, (16-19 maj 2016) Konferenca ndërkombëtare ,,10th Annual SEANCO", e organizuar nga US Army Europe-Rreshter Major e Komandës Lyon. Në të morën pjesë përfaqësues ushtarakësh të 26 shteteve të botës, kurse FSK-në e përfaqësoi rreshter majori i Komandës së Forcave Tokësore, Fatah Zejnullahu.Punimet e konferencës ishin të fokusuara në zhvillimin e nënoficerëve në ushtritë e botës, qoftë në fushën kombëtare, qoftë në atë ndërkombëtare. ,,Pjesëmarrja e FSK-së, në mesin e 26 shteteve është një eksperiencë e mirë për NOF të FSK-së, për bashkëpunimin dhe për zhvillimin profesional në nivel ndërkombëtar"- është shpreh rreshter majori Zejnullahu, i cili gjithashtu tha, se:,,ky bashkëpunimin në mes të shteteve që janë pjesë e NATOS, edhe partneriteti për paqe ndikon në ecjen drejtë rrugës dhe synimeve të vetë udhëheqësit të FSK-së".

Kadetëve të FSK-së të pranuar "WestPoint" iu dorëzuan certifikatat e pranimit

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK) më 03 maj 2016, u mbajt ceremonia e dorëzimit të certifikatave për dy kadetët e FSK-së, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku të cilët janë pranuar për studime në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (AUSHBA) ,,WestPoint". Fillimisht, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë, z. HakiDemolli foli për rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët strategjik, sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ushtrinë e Amerikës si dhe Gardën Kombëtare të Aiovës, bashkëpunime këto, që po hapin perspektivë të re për Ministrinë dhe Forcën e Sigurisë. Më këtë rast, ministri Demolli tha se lajmi për pranimin e dy kadetëve të FSK-së, në Akademinë ushtarake ,,WestPoint", është një prej ngjarjeve më të mira dhe shumë të rëndësishme për FSK-në dhe Ministrinë për FSK-në, sepse bëhet fjalë për shkollimin dhe ngritjen profesionale të dy kuadrove tona në një akademi ushtarake me traditë të gjatë. Ministri Demolli, gjatë ceremonisë, gjithashtu tha se: ,,Ministria për FSK-në, dhe Qeveria e Kosovës falënderojnë SHBA-të për përkrahjen gjithëpërfshirëse që në vazhdimësi po i ofrojnë Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë në të gjitha sferat e mundshme, që nga trajnimet, arsimimi dhe shkollimi, donacionet në pajisje dhe financa, këshillimeve profesionale e deri të shërvitjet e përbashkëta".

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama u shpreh tejet i lumtur, që kadetët e FSK-së, këtë vit po fillojnë studimet në Akademinë Ushtarake ,,WestPoint", akademi me renome botërore. Gjeneral Rama, tha se, ndjehet shumë krenar që promovon këtë sukses, e veçanërisht se ndjehet mirë këtu në mesin e dy kadetëve, që sot pranojnë certifikatat e pranimit në Akademinë Ushtarake më prestigjioze në botë. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, më tej shtoi se: „Dëshiroj të përgëzojë Arilenën dhe Yllin për suksesin e arritur deri më tani. Këta dy të rinj kanë arritur që të jenë në mesin e 10 kandidatëve më të mirë prej qindra konkurrentëve nga 150 shtete të ndryshme të Botës, që konkurruan për studime në ,,WestPoint".

Gjenerali Rama, aktin e pranimit të kadetëve e ndërlidhi edhe me procesin nëpër të cilin po kalon







FSK-ja, për planet për të ardhmen, Ai shtoi: ,,Ne si institucion jemi në një fazë kur përgatitemi për të marrë detyra dhe obligime shtesë në mbrojtje të vendit. Detyra jonë, tani është, që të planifikojmë, zhvillohemi dhe përgatitemi që kurdo që të merret vendimi politik ne ta bëjmë transformimin dhe të marrim detyrat e reja. Ne, tha Ai do të koordinojmë me gjithë akterët vendor dhe ndërkombëtar, dhe së bashku me ndihmën e partnerëve tonë, do të ndërtojmë një force të vogël, profesionale, multietnike, që është në të mirë të vendit, dhe gjithë qytetarët e Kosovës, dhe që do të kontribuoj në sigurinë regjionale dhe ndërkombëtare.

Pranimi në ,,WestPoint" dhe suksesi i kadetëve tuaj në Akademinë e Mbretërisë së Bashkuar ,,Sundhurst', dëshmon që FSK-ja është duke mbledhur talent të jashtëzakonshëm në mesin e saj. SHBA-tëjanë krenare që mbështesin Kosovën dhe momentet si kjo na tregojnë për përparimin që po ndodh këtu. Arelena dhe Ylli do të vazhdojnë me marrëdhënien e veçantë që populli i Kosovës e ka pasur me Forcat ushtarake amerikane që nga viti 1999. Kadetët, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku janë kadetët e parë të Forcës së Sigurisë së Kosovës që kanë konkurruar dhe janë pranuar në Akademinë Ushtarake Amerikane ,,WestPoint. Ata do të studiojnë në këtë Akademi për katër vite dhe pas diplomimit do të kthehen për ti shërbyer vendit tonë.

Tetar Rafet Gashi ushtari më i mirë i FSK-së për vitin 2016

Ceremonia solemne për shpalljen e rezultateve të garës tradicionale „Ushtari më i mirë për vitin 2016", u mbajt në Kazermën „Adem Jashari", gjegjësisht në amfiteatrin e Brigadës për Mbështetje Operacionale(BMO), më 5 maj 2016, ku të pranishëm ishin: Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë(MFSK), z. HakiDemolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama, drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s, për FSK-në, gjenerali ErnestHorn, zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, zëvendës komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), kolonel Irfete Spahiu, zëvendës komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së, kolonel MuharremRrahmani, atasheu ushtarak amerikan, kolonel ChadButts, si dhe oficerë dhe nënoficerë tjerë të FSK-së dhe KFOR-it. Në fjalën e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama tha se; me këtë garë, FSK-ja promovon shpirtin garues të nënoficerëve dhe ushtarëve tanë, të rrisim motivimin dhe të krijojmë traditë në këtë garë. Ai përshëndeti të gjithë ushtarakët garues për rezultatet e arritura, ku shtoi: „Rezultatet tuaja na bëjnë krenarë, dhe bazuar në këtë, mund të themi se të gjithë ju jeni fitues. Këto rezultate janë treguesi më i mirë, se FSK-ja është në rrugë të mirë për arritjen e standardeve të larta dhe shumë profesionale".

Në fund, gjenerali Rama përgëzoi të gjithë ushtarët që morën pjesë në garë e në veçanti tre ushtarakët që arritën rezultatet më të larta. Nga ana e tij, rreshter majori i FSK-së, Genc Metaj foli për rolin dhe rëndësinë e garës „Ushtari më i mirë i FSK-së" dhe në veçanti u ndal te gara e këtij viti, disiplinat në të cilat ushtarakët garuan, si dhe motivimin dhe entuziazmin e tyre përgjatë gjithë kohës së garave në të gjitha njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në fund të ceremonisë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama, tre më të mirëve u dha certifikata; RafetGashi, tetar nga Batalioni i Parë i Reagimit të Shpejtë, doli i pari në garën „Ushtari më i mirë për vitin 2016", vendin e dytë e zuri tetar BinakPodrimqaku, Batalioni i Dytë i Brigadës për Reagim të Shpejtë, kurse vendin e tretë, tetar Migjen Shala nga Regjimenti i Mbrojtjes Civile. Ndërsa, Ministri HakiDemolli, gjeneral Rama, gjeneral Horn, kolonel Butts dhe rreshter Genc Metaj u dhanë certifikata 22 pjesëmarrjeve të cilët garuan dhe me sukses përfunduan garën në disiplinat: navigim, fitnes fizik, marshim dhe njohuri të përgjithshme nga fushat ushtarake. Gara u zhvillua fillimisht në të gjitha njësitet e Forcës së Sigurisë, ndërsa më të mirët, 22 prej tyre, për tri ditë radhazi, më, 25, 26 dhe 27 prill, në Kazermën „Skënderbeu" në Ferizaj, zhvilluan një garë të rreptë dhe të fortë. Ky është viti i tretë, që në FSK mbahet gara për zgjedhjen e ushtarit më i mirë të vitit. Vitin e kaluar, më i miri u shpallë, tetari Migjen Shala, ndërsa në garën e parë, vitin 2014, e fitoi tetar Binak Podrimqaku.



Ekipet e BRSH-së të FSK-së më të mirat në garën "Ujku Garues-2016"

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, në Istog, më 20.05.2016, u mbajt ceremonia e shpalljes së rezultateve të ekipeve fituese në garën "Ujku Garues 2016". Ujku Garues është një garë e matjes së shkathtësive ushtarake e cila është e fokusuar në gjashtë disiplina: Vrapim 3. 2 km, Hedhja e Granatës, Shtyrja e Autoblindës(Cobra), Vëzhgimi (Identifikimi i pajisjeve ushtarake), Kalimi i Zonës së Minuar dhe Kalimi i Zonës së Rrezikshme. Është viti i dytë më radhë, që Brigada e Reagimit të Shpejtë e organizon këtë garë, në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në të cilën pjesëmarrësit marrin pjesë si ekip, dhe garojnë si një trupë e përbashkët. Këtë vit, kanë marrë pjesë 14 ekipe, me nga pesë pjesëtarë: Batalioni i Parë, i Dytë dhe i Tretë, Brigada e Mbështetjes Operacionale, KFOR-i amerikan dhe KFOR-i slloven. Në ceremoninë e përmbylljes me sukses të garës ,,Ujku Garues 2016" të pranishëm ishin edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant RrahmanRama, komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, gjeneral brigade ZymerHalimi, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve në Ministrinë për FSK-në, zëvendës komandanti i Forcave Tokësore(KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-së, për FSK-në, NLAT-it, gjeneral brigade ErnestHorn, komandanti i Grupit Luftarak-Lindje, kolonel Gamon, këshilltari i Komandantit të FSK-së, kolonel Layton dhe koloneli Turgut, përfaqësues të Ushtrisë së Sllovenisë që veprojnë në Kosovë,



Shtabi i BRSH-së, komandantët e batalioneve, oficerë dhe nënoficerë të BRSH-së, si dhe të njësive tjera të FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRamapasi përgëzoi Brigadën për Reagim të Shpejtë për organizimin e shkëlqyeshëm të kësaj gare, si dhe faleënderoi ekipet pjesëmarrëse të FSK-së, tha se: „Gara "Ujku Garues 2016" ka për qëllim të promovojë shpirtin garues të ushtareve, të rrisë motivimin e tyre, t'i testojë shkathtësitë ushtarake dhe ta koordinojë punën ekipore, sepse në ushtri puna ekipore është mënyra e vetme për të përmbushur misionin si dhe ngritjen profesionale individuale dhe ekipore" ka deklaruar gjeneral Rama. Ai ka theksuar se ushtarët, të cilët morën pjesë në këtë garë, kanë treguar profesionalizëm, përkushtim dhe njohuri shumë të mira të shkathtësive ushtarake. „Rezultatet që ju treguat na bënë, që



ne të gjithë të mburremi me juve dhe mund të them se ne të gjithë jemi fitues. Si komandant i FSK-së jam tepër krenar që pjesëtarët tanë janë çdo dite krah për krah me partnerët tanë në trajnime dhe gara të ndryshme dhe shpresoj se së shpejti të marrin pjesë edhe në misione të ndryshme. Pjesëtarët tanë gjatë garave të ndryshme kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme, ku së fundmi në garën ushtarake në Kroaci, toger Manushaqe Nura zuri vendin e parë në kategorinë e femrave dhe tetar BinakPodrimqaku vendin e tretë. Pastaj, pjesëtarët tanë që zunë vendin e parë në garën e ushtarit më të mirë në Bondsteel, vendin e parë në garën „ SllovenienChallenge" të organizuar në kampin „Villago Italia" e shumë suksese në gara dhe trajnime të ndryshme, e me këtë po dëshmojmë se ne jemi të gatshëm për të marrë detyra të reja në mbrojte të vendit dhe kontribuues të sigurisë. Ndërsa komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, pasi ka uruar të gjitha ekipet për sukseset dhe pjesëmarrjen në këtë garë, ka thënë se kjo brigadë është duke vazhduar ngritjen profesionale në kuadër të misionit të saj. "Një ndër aktivitetet e BRSH-së, që është duke kontribuar në ngritjen e punës ekipore dhe shpirtit garues në Brigadën tonë, është gara "Ujku Garues 2016" e dizajnuar fillimisht si garë në kuadër të BRSH-së, ndërsa këtë vit i ka kaluar këto parametra, duke u shndërruar në garë në nivel të FSK-së, me pjesëmarrje të ekipeve nga BMO-ja, dhe të ushtrive të NATO-s, që veprojnë në kuadër të misionit të KFOR-it, në Kosovë. Në fund të garës, në bazë të përformancës së treguar në të gjitha disiplinat e kësaj gare, u përzgjodhën tri ekipet më të mira. Vendin e parë dhe të dytë i kanë zënë ekipet e BRSH-së, ndërsa vendin e tretë Batalioni i Xhenios të BMO-së. Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama dhe komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, ekipeve pjesëmarrëse në garë u dhanë certifikata, ekipeve fituese mirënjohje, ndërsa ekipeve të ushtrisë amerikane dhe asaj sllovene, Mirënjohje dhe emblemën e Brigadës për Reagim të Shpejtë. Gjithashtu, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama nderoi me mirënjohje toger Manushaqe Nurën për suksesin e arritur në garën ndërkombëtare në Kroaci e cila zuri vendin e parë në disiplinën e femrave.



Ministri i FSK-së, HakiDemolli priti ministrin e Veteranëve dhe atë të Kulturës të Republikës së Kroacisë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. HakiDemolli, i shoqëruar nga zëvendësministrat Fadil Gashi dhe MuhametLatifi, gjeneral brigade ZymerHalimi, më 26 maj 2016, priti në një takim pune, një delegacion të Republikës së Kroacisë, të prirë nga ministri i Veteranëve të Republikës së Kroacisë, z. TomoMedved në cilësinë e të deleguarit të veçantë të presidentes së Republikës së Kroacisë, znj. KolindaGrabarKitaroviq, si dhe ministri i Kulturës, ZlatanHasanbegoviq. Ministrat Medved dhe Hasanbegoviq, shoqëroheshin edhe nga zëvendës ministri i veteranëve të Kroacisë Miroslav Cindriq, ambasadorja e Kroacisë në Prishtinë, znj. MarijaKapetanoviq, veterani i luftë së Kroacisë, gjeneral KadriKastrati(ish komandant i FSK-së) përfaqësuesi i krye bashkiakut të qytetit të Zagrebit, dr. Gëzim Rexhepi, kryetari i unionit të shqiptarëve në Republikën e Kroacisë, Esad Çollaku, kryetari i shoqatës së veteranëve shqiptar, TomKaçinari dhe veteranë të luftës në Kroaci. Ministri Demolli, ka falënderuar delegacionin e Kroacisë, për vizitën si dhe për bashkëpunimin që kanë me Republikën e Kroacisë, të



Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së, me ministrinë e Mbrojtjes dhe Ushtrinë e Kroacisë. Ministri HakiDemolli, gjithashtu delegacionin e Kroacisë e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, bashkëpunimin shumë të ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes të Kroacisë, me theks të veçantë mbështetjen që Republika e Kroacisë po jep në drejtim të anëtarësimit të Kosovës në iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë, etj. Nga ana e tij, Ministri Demolli e theksoj se Kosovën dhe Kroacinë i mban afër historia e ngjashme, gjithashtu diaspora shqiptare në Kroaci si dhe minoriteti kroat që jeton në Kosovë, duke shpreh gjithashtu edhe mirënjohje për shërbimin shumëvjeçarë të Kontingjentit ushtarak kroat në kuadër të KFOR-it në Kosovë. Ai, tha se Kroacia ka përvojë më të gjatë në administrimin dhe përkujdesjen e veteranëve dhe se do të ishte me dobi të madhe nënshkrimi i një memorandumi të bashkëpunimit ndërmjet dy qeverive, në dikasteret përkatëse për të shkëmbye përvojat e rregullimit të shumë çështjeve lidhur me veteranët. Ministri Demolli autoriteteve kroate u shprehu gjithashtu nevojën për njohje dhe avancim të statusit të shqiptarëve nga Kosova veteranë të



luftës së Kroacisë. Në emër të delegacionit të Republikës së Kroacisë, të cilët, kanë sjellë eshtrat e dëshmorëve shqiptarë të rënë në luftën për çlirim të Kroacisë, në Kosovë, foli ministri i Ministrisë për Veteranë të Kroacisë, z. TomoMedved i cili falënderoi ministrin Demolli për pritjen, duke theksuar se ndjehet jashtëzakonisht mirë që për herë të parë si Ministër vjen në Kosovë, në atdheun e bashkëluftëtarëve të tij, shqiptarëve nga Kosova, tani heronj të Kroacisë, të cilët në ditët më të vështira u rreshtuan në luftë përkrah popullit kroat për ta mbrojtur Kroacinë nga agresioni serb. Ministri kroat i veteranëve u shpreh i gatshëm për bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës për çështje të veteranëve, duke theksuar se përvoja e tyre në këtë fushë mund t'i shërbejë Kosovës në përkujdesje adekuate për këtë kategori të veçanta të shoqërisë, e cila, siç tha ministri kroat, z. Medved është meritore për lirinë dhe shtetin tuaj, ashtu siç janë veteranët e Kroacisë meritor për lirinë dhe pavarësinë e Kroacisë. Delegacioni kroat ka ardhur në Kosovë, me qëllim të rivarrosjes së eshtrave të qytetarëve shqiptarë nga Kosova, të rënë luftën për mbrojtjen e Kroacisë, tani dëshmorë dhe heronj të luftës së Republikës së Kroacisë.

Gjenerali i NATO-s Ernest Horn vizitoi Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, më 4 maj 2016, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu priti në një takim pune drejtorin e Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NLAT) gjeneral brigade ErnestPeterHorn dhe stafin e tij. Në këtë takim, kolonel Spahiu dhe gjenerali Horn biseduan për arritjet e përgjithshme të KDS-së, zhvillimet dhe nevojat e bashkëpunimit për të ardhmen. Kolonel Spahiu po ashtu e njoftoi gjeneralin Horn për aktivitetet dhe të arriturat e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Ata gjithashtu biseduan edhe për bashkëpunimin e KDS-së me stafin e NLAT-it, sidomos në Rishikimin e Plan Programeve të Stërvitjeve të Qendrave Shkollore. Me këtë rast, kolonel Spahiu e falënderoi gjeneralin Horn për ndihmën e vazhdueshme edhe të ekipit të tij, dhe premtoi se do të vazhdojë bashkëpunimin edhe në të ardhmen me ekipin e NLAT-it të cilët po kontribuojnë në ngritjen dhe avancimin e vazhdueshëm të KDS-së. Pas këtij takimi, përmes një brifingu informues për aktivitet aktuale që zhvillohen në KDS, gjeneralin Horn e njoftoi shefi i Shtabit të KDS-së, nënkolonel Fadil Hoxha. Në fund, drejtori i NLAT-it, gjenerali Horn premtoi ndihmë profesionale, në aspektin këshillëdhënës, dhe në trajnimin e instruktorëve dhe stafit të KDS-së. Ai, në Qendrat Stërvitore, tha se: "ndjehet i mahnitur me të arriturat e KDS-së, që nga vizita e tij e parë, si dhe me avancimin e nivelit të përgatitjes së instruktorëve".



Kadetët e Kosovës në shënimin e Ditës së Personelit Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura të Turqisë

Në Akademinë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në Ankara, më 27 maj 2016, është shënuar Dita e Personelit Ushtarak Mysafir (MAP Günü). Në këtë ditë i gjithë personeli i huaj, pjesëmarrës nga 20 shtete të ndryshme të botës, përfaqësoi vendin e vet përmes veshjeve kombëtare, uniformave ushtarake, ushqimeve tradicionale, fotografi me bukuritë natyrore, broshura të ndryshme rreth organizimit dhe aktiviteteve ushtarake, etj. Në organizim të atasheut ushtarak të FSK-së, në Ankara, nënkolonel Bekim Osmani, Republikën e Kosovës e prezantuan edhe 11 kadetët e Kosovës që studiojnë në Akademinë Ushtarake në Turqi, ndërsa të pranishëm ishin edhe 7 kadetë që janë duke vijuar mësimet në Fakultetin e Mjekësisë Ushtarake (GATA). Kadetët e Kosovës prezantuan shkëlqyeshëm Republikën e Kosovës, FSK-në, ushqimet dhe veshjen tradicionale të vendit tonë. Këtë vit, niveli i pjesëmarrjes ishte shumë i lartë, ku për ta përcjellë këtë ngjarje ishte edhe komandanti i Forcave Tokësore të FA Turke, gjeneral SalihZeki Çollak bashkë me disa gjeneralë të tjerë, të cilin, atasheu Osmani e njoftoi me historinë dhe bukuritë natyrore



të Kosovës.
Gjenerali Çollak dhe ushtarakët turq vizituan edhe këndin e ushqimeve tradicionale, ku të pranishmit patën rastin që të shijojnë ushqime tona tradicionale. Kadetët tanë, në mënyrë të shkëlqyer kishin përgatitur këndin e përfaqësimit dhe këndin e ushqimeve të cilat u vlerësuan nga Komandanti i FT, Komandanti i Akademisë Ushtarake dhe të gjithë të pranishmit tjerë. Në fund, atasheu ynë në Turqi, nënkolonel Bekim Osmani u kujdes që disave nga mysafirët e veçantë tu jap nga një dhuratë simbolike me motive nga Republika e Kosovës. Manifestimi është tradicional dhe organizohet çdo vit. Edhe këtë vit, paraqitja e kadetëve tanë u realizua me përkrahjen e FSK-së, ambasadës së Republikës së Kosovës në Ankara dhe familjeve të stafit të ambasadës.

FSK mban ushtrimin fushor „Kursi i Avancuar për Lider"

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK) në Ferizaj, është duke u realizuar Kursi i Avancuar për Lider nga Qendra për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve. Në këtë kurs, po marrin pjesë 27 pjesëtarë të gjitha njësive të FSK-së, në koordinim të instruktorëve të KDS-së dhe instruktorëve të KFOR-it, amerikanë. Kursi në vete përmban disa tema, të cilat e bëjnë më të veçantë dhe më sfidues ushtrimin. Në kuadër të këtij programi po demonstrohet në praktikë, njëra nga temat më të rëndësishme, evakuimi mjekësor i të plagosurve nga vija e zjarrit, në asistimin e instruktorëve amerikanë. Këtë ushtrim, nga afër e ka përcjellë zëvendës komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, stafi i lartë i KDS-së, FSK-së dhe KFOR-i amerikan në Bondstill. Gjeneral Hazrolli me këtë rast, ka përgëzuar pjesëtarët e FSK-së, për demonstrimin e ushtrimit dhe instruktorët për angazhimin e tyre, si dhe ka falënderuar ekipin e instruktorëve amerikanë për mbështetje në realizimin e këtij trajnimi. Ndërsa, kolonel Irfete Spahiu u nda shumë e kënaqur me angazhimin e pjesëtarëve dhe instruktorëve të KDS-së. Kolonel Spahiu falënderoi kontributin e madh të KFOR-it amerikan: "Kontingjenti amerikan në Bondstill, është duke dhënë një kontribut të veçantë, me mbështetje pothuajse në të gjitha kërkesat tona dhe kjo është një dëshmi e qartë se këtë trajnim, nuk do të kishim mundësi ta realizonim pa ndihmën e pjesëtarëve të KFOR-it, amerikan". Demonstrimi; tërheqja e pjesëtarëve nga vija e zjarrit është një risi për pjesëtarët pjesëmarrës të FSK-së, për vetë faktin se gjatë këtij kursi, është ushtruar edhe me helikopter për



evakuimin e tyre. Instruktorët amerikanë të cilët po e monitorojnë kursin, gjatë ushtrimit janë shprehur se ndjehen të fascinuar me përkushtimin e pjesëtarëve të FSK-së, për të realizuar këtë ushtrim dhe për të demonstruar aftësitë e tyre taktike dhe fizike gjatë tërë kohës. Kursi do të vazhdojë deri më, 03.06.2016. Gjatë javës së dytë pjesëtarët e FSK-së, kanë demonstruar aftësitë e tyre në trajnime tekniko-taktike dhe janë vlerësuar për rezultate të larta të arritura gjatë tërë kohës. Vlen të theksohet, se këtë kurs në gjeneratën e parë e kanë mbajt instruktorët amerikanë, ndërsa tani po realizohet nga instruktorë të KDS-së, nën mbështetjen dhe monitorimin e instruktorëve të KFOR-it amerikanë në Bondstill.

FSK-ja në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën"

Pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe udhëheqës të saj, më 24 maj morën pjesë në aksionin në nivel vendi, me moton "Ta pastrojmë Kosovën". Aksioni "Ta pastrojmë Kosovën" filloi në Lagjen Kalabria në Prishtinë, ku morën pjesë, gjeneral brigade ZymerHalimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel NaimHaziri, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, FeridAgani, ish-presidentja e Kosovës, znj. AtifeteJahjaga, përfaqësues dhe vullnetarë të iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën", nxënës të shkollave fillore të Prishtinës, si dhe vullnetarë e qytetarët të tjerë. Me këtë rast, gjeneral Halimi përshëndeti pjesë-



marrësit e aksionit për pastrimin e ambientit, nxënësit e shkollave fillore, ushtarët e FSK-së dhe qytetarët e Kosovës. Ai, ndër të tjera tha: "Këtë aktivitet e kemi bërë tashmë tradicional në gjithë Kosovën. Sot, po marrim pjesë dhe po kontribuojmë në pastrimin e ambientit sepse është në të mirën e fëmijëve dhe qytetarëve tanë. Ai, shtoi se, FSK-ja si zakonisht ka përkrahur dhe do të përkrahë aksionet e tilla, që janë në dobi të Kosovës. "Ne, sot jemi angazhuar në shumë qytete të Kosovës, me ushtarë dhe me një pjesë të mjeteve-makinerisë të rëndë, si kamionë dhe ngarkues, si në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Fushë Kosovës" etj.
Ndërsa, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor FeridAgani, pas që falënderoi FSK-në, për përkrahjen e aksionit me ushtarë dhe makineri të rëndë, tha. "Kjo sot që po e shohim është një dëshmi e fuqisë së qytetarisë së Kosovës, që tregon se edhe ne jemi pjesë e Evropës, duke treguar një përkushtim të madh për mjedisin dhe kjo më bënë shumë optimist që në ditët e ardhshme do ta kemi shtetin tonë ashtu siç jemi vetë". Ish presidentja Kosovës, znj. AtifeteJahjaga mori pjesë në pastrimin e Kosovës dhe njëherë bëri thirrje për një kujdes më të madh të qytetarëve për ruajtjen e mjedisit. Kurse, koordinatori i Iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën", Luan Hasanaj, tha se vetëm gjatë ditës së sotme aksionin po e përkrahin mbi 50.000 vullnetarë, dhe kemi paraparë mënjanimin e mbi 150 deponive ilegale në mbarë vendin. Zoti Hasanaj falënderoi qytetarët dhe në veçanti Forcën e Sigurisë së Kosovës për përkrahje të vazhdueshme dhe ndihmën e saj, me makineri të rëndë. FSK-ja, në aksionin e sotëm, ta pastrojmë Kosovën, ka pastruar dhe larguar nga deponitë ilegale qindra tonë mbeturina.

Mbahet punëtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Në hotelin Emerald në Prishtinë, në kuadër të Projektit Qeveritar me Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë, koordinuar nga QKSS, në mbështetje të Departamentit të Personelit në MFSK, më 12 maj 2016, u mbajt "Punëtoria për Hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në FSK, Qasja, Përgjegjësitë dhe Përcaktimi i Afateve kohore".
Në këtë punëtori morën pjesë: z. SveinEriksen, këshilltar i Lartë i CIDS, DamirAhmetovic, ekspert rajonal i MBNJ, Mentor Vrajolli (QKSS), drejtori i NAT-it, z. Domenic, drejtori i Drejtorisë për Operacione dhe Trajnime, gjeneral brigade ZymerHalimi, z. FarukGeci, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, kolonel Skënder Zhitia, drejtor i Departamentit të Personelit, AzemSmajli ushtrues detyre i Departamentit për Politika dhe Plane, si dhe shefat e sektorëve të Departamentit të Personelit. Gjatë kësaj punëtorie u bënë prezantime të bartësve të projektit si dhe u diskutuan modalitetet rreth hartimit të Draft Strategjisë së Departamentit të Personelit si dhe rreth detyrave dhe përgjegjësive të saj.





Pjesëtarët e FSK-së në Gjysmëmaratonën Ndërkombëtare të Prishtinës

Në gjysmëmaratonën ndërkombëtare në atletikë të mbajtur më 16 maj, në Prishtinë morën pjesë edhe 37 pjesëtarë të FSK-së, ku 32 prej tyre vrapuan në shtegun e gjatë prej 21 kilometrash, ndërsa pesë të tjerë vrapuan në gjatësi prej 5 kilometrash.
Në këtë gjysmëmaratonë vrapoi edhe rreshter majori FetahZejnullahu me uniformë dhe me 10 kg. peshë në shpinë. FSK-ja, gjysmëmaratonën e Prishtinës e ka mbështetur edhe me një ekip mjekësor, i cili ka intervenuar në shumë raste, në ndihmë të pjesëmarrësve, si pasojë e lëndimeve gjatë vrapimit. Togerja e FSK-së, Manushaqe Nura, në gjysmëmaratonën e Prishtinës, në kategorinë e seniorëve zuri vendin e pestë, me kohë 1.44:00.

Brigada e Reagimit të Shpejtë mbajti trajnimin "Personi i parë në vendngjarje"

Në Brigadën për Reagim të Shpejtë(BRSH), më 27 maj u mbajt ceremonia e certifikimit të trajnimit "Personi i Parë në Vendngjarje" që u realizua nga ekipi ushtarak dhe zyra e atasheut ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar. Komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm që ka FSK-ja me Mbretërinë e Bashkuar dhe kontributin që këta të fundit kanë dhënë në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Ai pos tjerash, tha se; ,,Trajnimi "Personi i Parë në Vendngjarje" me ekipin profesional britanik në lëminë e mjekësisë si dhe trajnimet taktike me BIMAT-in, si brenda ashtu edhe jashtë vendit janë duke kontribuar në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve operacionale të BRSH-së. Shtrirja e këtij trajnimi ka rëndësi të veçantë për BRSH-në, sepse me këtë shtrirje ne po krijojmë një standard unik për këtë lëmi në gjithë BRSH-në. Krijimi i një standardi për reagimin e parë mjekësor në vendngjarje, ka rëndësi të veçantë për pjesëtarët e Brigadës së Reagimit të Shpejtë. Ky standardizim do të ndihmojë në avancimin e ndërveprueshmërisë, efikasitetit dhe sigurisë gjatë zhvillimit të operacioneve". Komandanti i BRSH-së, kolonel Geci i ka shprehur falënderim këshilltarit të Komandantit të FSK-së, kolonel AndyLayton për punën dhe përpjekjet e vazhdueshme që po bënë për zhvillimin e FSK-së, si dhe instruktorëve të ekipit të Mbretërisë së Bashkuar.



Sipas vlerësimeve nga ekipi britanik dhe instruktorëve të BRSH-së, motivimi i pjesëtarëve për këtë trajnim ka qenë i lartë, angazhimi dhe pjesëmarrja gjatë kursit kanë qenë gjithashtu në nivel shumë të lartë. Gjatë trajnimit të gjithë pjesëmarrësit kanë përfunduar me sukses testimin. Trajnimi është zhvilluar nga data 16-27.05.2016. Këtë trajnim e kanë ndjekur gjithsejtë 23 pjesëtarë të BRSH-së.

Batalioni i Parë realizoi trajnimin "Lëvizja taktike me autoblinda"



Komandanti i kontingjentit të KFOR-it turk, kolonel SaimBagci së bashku me bashkëpunëtorë, më 18 maj vizitoi Batalionin e Parë të Reagimit të Shpejtë, në Gjilan.
Delegacioni turk u prit nga komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) të FSK-së, kolonel Xhevahir Geci dhe komandanti i Batalionit të Parë, nënkolonel HakiXhemajli.
Me këtë rast, komandanti i BRSH-së, kolonel Geci, falënderoi komandantin e kontingjentit të KFOR-it turk, për mbështetjen e vazhdueshme që trupat e ushtrisë turke janë duke i dhënë Brigadës për Reagim të Shpejtë, gjatë trajnimeve dhe ushtrimeve tjera të ndryshme profesionale. Ndërsa, lidhur me trajnimin "Lëvizja taktike me autoblinda" i cili po realizohet nga ekipet mobile turke në bashkëpunim me Batalionin e Parë, delegacionin turk e njoftoi nënkoloneli HakiXhemajli. Më pastaj, të dy delegacionet përcollën nga afër demonstrimet taktike me autoblinda të pjesëtarëve të Batalionit të Parë të BRSH-së.
Në fund, koloneli Bagci u zotua për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, me qëllim të rritjes së aftësive profesionale të pjesëtarëve të Brigadës për Reagimit të Shpejtë dhe në përgjithësi të gjithë pjesëtarëve të FSK-së.

Varroset me nderime nënoficeri i FSK-së, tetar Lavdim Ademi

Në fshatin Shipol të Mitrovicës, më 1 maj 2016 u varros me nderime ushtarake nënoficeri i FSK-së, tetar Lavdim Ademi. Në ceremoninë e varrimit ishte i pranishëm komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve në Ministrinë për FSK-në, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore kolonel NaimHaziri, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) kolonel ShaipHaziri, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale(BMO), kolonel MuharremRrahmani, oficerë dhe nënoficerë të shumtë të FSK-së, si dhe qindra qytetarë të Kosovës.
Në emër të FSK-së, ngushëllime familjes, shokëve, miqve dhe kolegëve u shprehu komandanti i RMC-së, kolonel ShaipHaziri, i cili pos tjerash tha: ,,Jemi tubuar





sot këtu, që t'i japim lamtumirën e fundit birit tuaj e shokut tonë të luftës dhe të lirisë, tetarit Lavdim Ademit. Lavdimi si i ri, ishte brumosur me ide të lirisë dhe atdhedashurisë ku rreshtohet në radhët e UÇK-së, në Brigadën ,,141 Mehë Uka" në Zonën Operative të Shalës, për të luftuar përkrah shokëve deri në përfundim të luftës. Në shtator të vitit 1999, me transformimin e UÇK-së, në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës vazhdon punën në Zonën e Katërt Mbrojtëse në Njësinë e Kërkim-Shpëtimit, ndërsa më 2009, Lavdimi me sukses i kaloi testet për ta vazhduar aktivitetin e tij profesional në FSK, po në lëminë e kërkim-shpëtimit, në Regjimentin e Mbrojtjes Civile. Unë si komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile ndjej krenari që kam pasur një nënoficerë të përgatitur, të disiplinuar dhe profesionalisht të ngritur. Ai ishte shumë i dashur për kolegët, ishte shembull për gjeneratat e reja se si duhet atdheu, dhe ishte shembull për t'i shërbyer atdheut. Lavdia dhe përjetësia i takon Lavdim Ademit. Ndërsa në emër të Organizatës së Veteranëve të Komunës së Mitrovicës, për jetën dhe veprën e Lavdimit, foli bashkëluftëtari i tij, MiftarKurti. Lavdim Ademi lindi më 4 nëntor të vitit 1973, në fshatin Zabërgjë. Shkollën fillore e kreu në Trepçë, kurse të mesmen në Mitrovicë. Ai nuk pati mundësi materiale ta vazhdoi shkollimin. Për ta mbajtur familjen detyrohet ta merr botën në sy. Pasi kthehet nga mërgimi keqtrajtohet mizorisht nga policia serbe. Lavdimi gjatë vitit 1998, ishte ndër të parët që i bashkohet Brigadës ,,Mehë Uka" edhe pse ishte shumë i ri. Ai shkoi në Shqipëri për sigurimin e armëve, për shokët e rinj të luftës. Lavdimi mori pjesë në shumë beteja, ndërsa, në atë të Mazhiqit plagoset rëndë, ku për një kohë shtrihet në spitalin ushtarak të Shalës. Lavdimi shërbeu me nder dhe të gjitha detyrat i kreu me përgjegjësi të lartë, gjatë dhe pas luftës. Lavdimi gjithashtu shërbeu në TMK dhe FSK-së. Ai ka lënë pas bashkëshorten dhe dy djem. Në emër të familjes Ademi, të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje në përcjelljen e fundit për në botën e përjetshme Hajriz Ademi. Në fund të ceremonisë familjes Ademi iu dorëzua Flamuri i Republikës së Kosovës me të cilin trupi i Lavdimit ishte i mbuluar dhe u përcoll për në banesën e fundit. Lavdim Ademi ndërroi jetë më 30 prill 2016, duke qenë në shërbim të Atdheut, në detyrën e zëvendës komandantit të rojës në kazermën e RMC-së, ,,Evropianët e Rinjë" në Pomozotin.

FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 48 • Korrik 2016 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Nënshkruhet Memorandum Bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Hungarisë

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli me ftesë të Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Hungarisë, z. István Simicskó, më 10 qershor 2016, qëndroi për vizitë zyrtare në Budapest. Të dy ministrat, Demolli dhe Simicsko në emër të ministrive të tyre, nënshkruan Marrëveshjen Dypalëshe të Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Në takimin dypalësh ministri i FSK-së, Haki Demolli e ka falënderuar Ministrin Simicsko dhe nëpërmjet tij shtetin dhe popullin hungarez për përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën, institucionet dhe popullin e saj. Më tej, Demolli theksoi se shteti i Hungarisë ka përkrahur Kosovën në të gjitha fazat e përpjekjeve të saj për shtet ndërtim, pastaj njohjen e realitetit të ri, pra njohjen e pavarësisë së Kosovës, gjithashtu, ministri Demolli tha se Hungaria ka kontribuar në përkrahje të stabilitetit dhe sigurisë në Kosovë e në veçanti duhet çmuar angazhimi i shtetit të Hungarisë në përkrahje të agjendës së Kosovës për anëtarësim në NATO dhe integrim në Bashkimin Evropian. Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes të Republikës së Hungarisë, Istvan Simicsko e konfirmoi edhe një herë mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në përgjithësi të Republikës së Hungarisë ofruar Republikës së Kosovës në të gjitha fushat, e sidomos në fushën e Integrimeve Euro-Atlantike. Marrëveshja e Dypalëshe e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Hungarisë ka për qëllim bashkëpunimin zyrtar në fushën e arsimimit dhe edukimit, shkëmbimit të përvojave në



rrugën e integrimeve Euro-Atlantike, në menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e krizave dhe të buxhetit, etj. Pjesë e delegacionit të ministrit Demolli ishin edhe zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore(KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i kabinetit të Ministrit të FSK-së, Latif Leka, shefi i Sektorit për Integrime Euro-Atlantike, Sinan Geci si dhe i ngarkuari me punë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Budapest, Visar Fetaj.

Ministria për FSK-në nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me Komandën e Evropiane të SHBA-ve



Në mjediset e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), me një ceremoni solemne të organizuar më 16 qershor 2016, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës(SHBA) lidhur me përdorimin e hapësirës në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për Zyrën për Bashkëpunim në fushën e mbrojtjes(US-ODC). Në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Memorandumin e Bashkëpunimit e nënshkroi sekretari i përgjithshëm, ndërsa në emër të Ambasadës së SHBA-ve e nënshkroi shefi i Zyrës për Bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes. Memorandumi i Bashkëpunimit është në përputhje të plotë me Marrëveshjen në mes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me statusin e Forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë (SOFA), e lidhur në Prishtinë, më 18 shkurt 2012. Qëllimi i nënshkrimit të këtij Memorandumi është lejimi i shfrytëzimit të hapësirave të caktuara të Ministrisë së FSK-së për nevoja të Zyrës për Bashkëpunim dhe Siguri(US-ODC) të SHBA-ve. Zyra për Bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes është strukturë përgjegjëse për bashkëpunim dypalësh në fushën e mbrojtjes në mes të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe strukturave ushtarake të Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Komandën Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga shefi i Zyrës për Bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes (US-ODC

MFSK-ja organizoi „Dëgjim publik" për ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me FAK-un

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), përkatësisht Zyra Ligjore e MFSK-së, në mjediset e saj, më 1 qershor 2016, organizoi „Dëgjimin publik" me shoqërinë civile lidhur me Projektligjin për ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës. Në këtë takim të pranishëm ishin: Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s për MFSK-në, Dominic-Haydn Braithwaite, drejtori i Drejtorisë për Operacione-gjeneral brigade Zymer Halimi, shefja e Zyrës për të Drejtat e Njeriut-Halime Morina si dhe këshilltarë të NAT-it. Punimet e konferencës për dëgjim publik i shpalli të hapura shefja e Zyrës Ligjore, znj. Krenare Sogojeva-Dermaku e cila paraqiti para të pranishmëve arsyen dhe nevojën e organizmit të këtij takimi. Fjalën e rastit e mbajti Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj i cili fillimisht foli për procesin e Rishikimit të Strategjisë të Sektorit të Sigurisë së Kosovës, rekomandimet e dala nga ky rishikim, si dhe procesin e planifikimit dhe përgatitjeve të Ministrisë për përgatitjen e ligjeve dhe amendamenteve kushtetuese që i hapin rrugë transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura. Ai shtoi se, MFSK-ja gjatë gjithë procesit të saj ka punuar ngushtë dhe në transparencë të plotë me Ekipin Këshillues të NATO-s për MFSK-në(NAT), Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për Forcën e Sigurisë(NLAT) si dhe me organizatën DIR- nga Shtetet e



Bashkuara të Amerikës. Ndërsa drejtori i NAT-it, Dominic-Haydn Braithwaite, gjatë fjalës së tij, u shpreh se Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka punuar fort në këtë proces në mënyrë që tërë pakon ligjore ta kompletojë dhe të zhvillojë përgatitjet e duhura para se institucionet të marrin vendim për transformim. Gjatë dëgjimin publik, nga ana e shefes së Zyrës Ligjore znj. Sogojeva-Dermaku dhe nga personeli tjetër i zyrës majori Brahim Kokollari dhe zyrtari Burim Abazi, u bë leximi nen për nen dhe pikë për pikë i ligjeve, dhe të njëjtit u përgjigjen në pyetjet e parashtruara si dhe dhanë sqarimet e nevojshme rreth temave, përmbajtjeve dhe formulimeve tjera. Kurse, përfaqësuesit e shoqërisë civile; organizatat joqeveritare vendore të cilat merren kryesisht me çështje të sigurisë, paraqitën nga ana e tyre komentet duke dhënë edhe disa propozime të cilat do të analizohen nga Zyra Ligjore e Ministrisë në të ardhmen. Nga ana e tij, Besfort Lecaj, përfaqësues i organizatës Asociacioni Euro-Atlantik, i përgëzoi udhëheqësit e Ministrisë për organizimin e dëgjimit publik si dhe parashtroi disa propozime për rishqyrtim dhe ndryshim eventual.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama përcolli trajnimin në kazermën "New Born" të FSK-së në Gjilan

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me komandantin e Brigadës për Reagim të Shpejtë(RSH), kolonel Xhevahir Gecin dhe me bashkëpunëtorët e tij, më 1 qershor 2016, vizitoi Batalionin e Parë për Reagim të Shpejtë të BRSH-së, në Gjilan, ku nga komandanti i saj, nënkoloneli Haki Xhemajli u njoftuan me aktivitetet e përgjithshme të këtij batalioni. Vizita e komandantit të FSK-së, gjeneral Ramës me bashkëpunëtorë në Gjilan, ka qenë e fokusuar në përcjelljen e trajnimit "Shoferë, mirëmbajtje dhe lëvizje taktike me autoblinda", që është duke u realizuar nga ekipet mobile turke e mbështetur edhe nga instruktorët e BRSH-së. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama ka falënderuar ekipet mobile turke për bashkëpunimin që po ofrojnë në ngritjen profesionale të FSK-së, si dhe pjesëtarët e BRSH-së për angazhimin e tyre në realizimin e këtij trajnimi. Më pastaj, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, përcolli nga afër operacionet taktike me autoblinda si dhe demonstrimet dhe operimet e ndryshme të pjesëtarëve të këtij batalioni. Ky trajnim po zhvillohet me shumë sukses. Ndërsa, komandanti i BRSH-së, koloneli xhevahir Geci para gjeneral Ramës, shpalosi planet e avancimit dhe pavarësimit të kapaciteteve të BRSH-së, për operim me autoblinda. Kurse, majori Bede, përgjegjës i ekipit mobil turk, e informoi komandantin e FSK-së, për ecurinë e trajnimit me autoblinda, të realizuar në Brigadën për Reagim të Shpejtë në Istog dhe në Batalionin e Parë të BRSH-së në Gjilan. Majori Bede falënderoi komandantin e FSK-së dhe stafin e tij, për mbështetjen e ofruar gjatë realizimit të këtij trajnimi shumë të rëndësishëm për FSK-në.



Ministri Haki Demolli priti në takim lamtumirës këshilltarin amerikan të NATO-s, nënkolonelin Marlan Poage

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli më 21 qershor 2016, priti në një takim lamtumirës zëvendësdrejtorin e Ekipit Këshillues të NATO-s për FSK-në, nënkolonelin Amerikan Marlan Poage. Me këtë rast, ministri Demolli, në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, falënderoi nënkolonelin amerikan Poage për kontributin, përkushtim dhe angazhimin e tij profesional, që Ai dha në ngritjen e vazhdueshme të Ministrisë dhe FSK-së, gjatë shërbimit në MFSK. Ministri Demolli, duke iu drejtuar nënkolonelit Poage, më tej u shpreh: "Unë jam shumë mirënjohës për kontributin tuaj personal dhe profesional që keni dhënë në mbështetje për krijimin dhe zhvillimin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ju keni luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e Ministrisë sidomos mbështetjen në krijimin e Departamentit të Komunikimit dhe të FSK-së. Gjatë takimit, ministri Demolli në shenjë respekti për punën, angazhimin dhe kontributin e tij gjatë shërbimit në Kosovë, nënkolonelit amerikan Marlan Poage, i dhuroi ,,Certifikatë-Mirënjohje". Në fund ministri Demolli edhe një herë falënderoi nënkolonelin amerikan Poage si dhe Gardën Kombëtare të Ajovës dhe SHBA-të, për ndihmën e përgjithshme dhe të vazhdueshme që po japin për FSK-në. ,,Puna juaj në formulimin e koncepteve, politikave dhe proceseve të planifikimit ka vënë Ministrinë në rrugë të drejtë për të ardhmen. Unë e di që ju keni punuar shumë dhe me dëshirë keni ndarë njohuritë dhe përvojën tuaj me stafin tim, të cilët kanë përfituar shumë nga këshillat e juaja. ,,Unë jam me të vërtetë mirënjohës për ju dhe Gardën Kombëtare të Ajovës për ndihmën që i keni dhënë dhe po vazhdoni t'i jepni Ministrisë që unë e drejtoj dhe vendit tim". Ndërsa nga ana e tij zëvendësdrejtori i NAT-it, nënkoloneli Marlan Poage, u shpreh tejet i lumtur që pati rastin që për dymbëdhjetë muaj të punojë në Kosovë. Ai falënderoi ministrin Demolli, stafin udhëheqës të FSK-së dhe pjesëtarët e FSK-së, duke u uruar suksese të mëtejmë në realizimin e detyrave të përgjithshme.





Ministri Haki Demolli priti deputetët e Grupit parlamentar Gjashtë Plus

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli së bashku me zëvendësministrin Fadil Gashi dhe komandantin e Forcë së Sigurisë gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 2 qershor 2016, në mjediset e Ministrisë pritën deputetët nga Grupi parlamentar Gjashtë Plus të Kuvendit të Kosovës të prirë nga deputetja Mufera Ainik, shefe e këtij Grupi parlamentar. Fillimisht, ministri Demollli i njoftoi deputetët e Grupit parlamentar Gjashtë Plus me misionin, detyrat, aktivitetet dhe planet e Ministrisë dhe të FSK-së, në këtë proces. Me këtë rast, ministri Demolli tha se Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës i kanë zhvilluar të gjitha përgatitjet e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të dala nga Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë së Kosovës(RSSS) që i kanë takuar Ministrisë sonë, dhe se MFSK-ja dhe FSK-ja janë të gatshme për të filluar implementimin, gjegjësisht transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës(FAK). Ky proces është zhvilluar në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me Ekipin Këshilluese të NATO-s(NAT) për MFSK-në, Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në(NLAT) si dhe me organizatën e specializuar për rishikime të sektorit të sigurisë DIR nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA). Ministri i FSK-së, Haki Demolli u shpreh gjithashtu se MFSK-ja dhe FSK-ja me arsye pret që të gjithë deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës, si të zgjedhur të popullit, me votën e tyre, t'i hapin rrugë transformimit të FSK-së në FAK, e gjithashtu t'i hapin rrugë zhvillimit të saj dhe integrimit në strukturat euroatlantike. Duke u ndalur në zhvillimet e fundit në FSK, ministri Demolli theksoi se ashtu si FSK-ja edhe FAK-u sipas planifikimit do të jetë forcë profesionale, shumetnike, me përfaqësim gjinor pa kuota, si dhe e gatshme të shërbejë për vendin dhe t'iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim. Ndërsa, shefja e Grupit parlamentar 6+, znj. Mufera Ainik, Duda Balje, Danush Ademi dhe Kujtim Paqaku nga radhët e komuniteteve u shprehën mirënjohëse për takimin, si dhe për transparencën e plotë të udhëheqësve të Ministrisë dhe FSK-së, për procesin. Ata procesin e transformimit të FSK-së në FAK e shohin si progres dhe domosdoshmëri e ndërtimit, zhvillimit dhe funksionalizimit të institucioneve vitale të Republikës së Kosovës.

Seminaristët e Bundeswehrit gjerman vizituan Ambasadën e Kosovës në Berlin

Në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin, ambasadori Skënder Xhakaliu dhe atasheu i FSK-së, kolonel Xhavit Sadrijaj, më 8 qershor 2016, pritën një grup oficerësh të nivelit të lartë të Bundswehrit Gjerman, të cilët po ndjekin Seminarin Specialistik: Politika e Jashtme dhe e Sigurisë. Seminari specialistik është duke u zhvilluar në Qendrën për Udhëheqje të Brendshme të Bundeswehrit në Straussberg afër Berlinit. Një nga temat e rëndësishme është "Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Gjermanisë dhe Marrëdhëniet Bilaterale, në mes të Kosovës dhe Gjermanisë". Ambasadori Xhakaliu ligjëroi para pjesëmarrësve lidhur me marrëdhëniet dypalëshe në mes Republikën Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Kosovës, rolin e Gjermanisë në zhvillimin e Republikës së Kosovës, mbështetjen e përhershme që Gjermania po i ofron Republikës së Kosovës si dhe ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në kuadër të KFOR, të cilën është duke e bërë Bundeswehri Gjerman, që nga viti 1999. Ndërsa, koloneli Xhavit Sadrijaj, në ligjëratën e tij, foli lidhur më politikat e sigurisë rajonale, rolin e Republikës së Kosovës dhe të FSK-së, në sigurinë rajonale, dhe bashkëpunimin e mirëfilltë dypalësh në mes Bundeswehrit dhe FSK-së, trajnimet specialistike që po i zhvillon FSK-ja në qendrat specialistike të Bundeswehrit, si dhe zgjerimin e këtij bashkëpunimi i cili është edhe cak i rëndësishëm i atasheut të FSK-së. Oficerët pas përfundimit të ligjëratave shtruan pyetje të shumta për ambasadorin Xhakaliu dhe kolonelin Sadrijaj. Oficerët u shprehën shumë të kënaqur më informatat për Kosovën, të cilat do t'iu shërbejnë shumë posaçërisht atyre që janë duke u përgatitur për të marrin pjesë në njësitë e Bundeswehrit me mision në Kosovë, në kuadër të Kontingjentin gjerman që vepron nën Komandën e KFOR-it.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Në MFSK mbahet konferenca "Lansimi i Planit të Integritetit të MFSK-së"



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 28 qershor u mbajt Konferenca ,,Lansimi i Planit të Integritetit të MFSK-së", në të cilën morën pjesë: ministri Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministrat Gashi dhe Latifi, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, ambasadori i Norvegjisë Jan Braathy, drejtori i Qendrës së Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë, përfaqësues të NAT-it (Ekipit Këshilluese të NATO-s, në MFSK) dhe NLAT-it, (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, në FSK), atashetë ushtarakë të akreditуar në Kosovë, përfaqësues nga shoqëria civile dhe drejtorë të drejtorive të MFSK-së.

Plani i integritetit është hartuar si rrjedhojë e zbatimit të projektit "Mbështetje kornizës së integritetit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës," projekt ky që mbështetet nga Qendra e Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes (QISM) e Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë.

Plani i Integritetit i MFSK-së është plani i parë i hartuar në nivelin qendror qeveritar. Plani ka identifikuar rreziqet e mundshme institucionale si dhe ka nxjerr obligime për zbatimin e një mori detyrash në tri (3) vitet e ardhshme, në përputhje me bazën ligjore dhe dokumentet ekzistuese strategjike. Ky Plan pritet të zbatohet si pjesë e përpjekjeve të MFSK-së, për ngritjen dhe profesionalizmit të qeverisjes së mirë në rrugën për transformim dhe integrim në strukturat euro-atlantike. Punimet e Konferencës i hapi sekretari i Përgjithshëm i MSK-së, z. Shkëlzen Sylaj. Ai pos tjerash tha: Ky Plan është përpiluar dhe pritet të zbatohet si pjesë e përpjekjeve të MFSK-së, për ngritjen e profesionalizmit dhe qeverisjes së mirë në rrugën për transformimin e mandatit dhe integrim në strukturat euro-atlantike. Me këtë projekt MFSK përfiton në fuqizimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm për luftimin e dukurive të mundshme negative, duke i parandaluar ato si dhe përfiton në rritjen e transparencës, profesionalizmit dhe plotëson një kriter mjaftë të rëndësishëm duke bërë një hap përpara në procesin e partneritetit për paqe në mes të shtetit të Kosovës dhe NATO-s. Kurse, ministri i MFSK-së, Haki Demolli në fjalën e tij, falënderoi Qeverinë e Norvegjisë për mbështetjen pa rezervë në funksion të fuqizimit të kornizës së integritetit në MFSK: ,,Mbështetja dypalëshe e Mbretërisë së Norvegjisë dhënë Republikës së Kosovës përbënë një kontribut jo vetëm në ngritjen e integritetit në MFSK-së, por, para së gjithash, mbështetje në funksion të proceseve shtet-ndërtuese". Ndërsa për Integritetin, tha se: "paraqet një vlerë universale njerëzore, që konsiderohet si një normë kyçe në punën e institucioneve publike përderisa ka një lidhje të veçantë me strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë. Integriteti gërshetohet plotësisht me misionin, rolin, detyrat, objektivat dhe përgjegjësitë e institucioneve të mbrojtjes, caku primar i të cilave është ofrimi i sigurisë si një e mirë e përbashkët, qoftë në rrafshin lokal apo ndërkombëtar". ,,Ministria e FSK-së dhe Forca e Sigurisë së Kosovës qëndrojnë të përkushtuara për arritjen e standardeve të NATO-s. Kosova ka dëshmuar përkushtim të plotë për anëtarësimin në programin "Partneritet për Paqe" dhe më vonë anëtarësim të plotë në NATO. Ne jemi të përkushtuar në zbatimin e objektivave që kërkojnë ngritjen e integritetit në bazë të performancës në të gjitha nivelet e institucionit. Miratimi i planit përbën një hap të rëndësishëm të MFSK-së dhe Ministrisë së ardhshme të Mbrojtjes në përafrimin me nivelin e shteteve anëtare të NATO-s dhe partnerëve të saj. Në fund, Ai theksoi: ,,Kam besim të plotë në profesionalizmin dhe përkushtimin e personelit për zbatimin e të gjitha propozimeve që rrjedhin nga ky Plan i Integritetit, sepse motoja e jonë është "MFSK e bazuar në integritet". Ndërsa ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, zoti Jan Braathu theksoi se kjo është një ngjarje shumë e rëndësishme për FSK-në, dhe për këtë e përgëzoj lidershipin e Ministrisë dhe FSK-së. Kjo punë e mirë e shtynë Norvegjinë që ta mbështesë edhe më shumë Kosovën drejt realizimit të Partneritetit për Paqe dhe thellimit të bashkëpunimit me NATO-n. Kurse drejtor i Qendrës së Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes të Ministrisë së Mbrojtjes të Norvegjisë, z. Per Age Christensen theksoi se ky projekt është shumë me rëndësi për MFSK-në, me çka realizimi i saj, hap rrugë drejt anëtarësimit në NATO, si dhe thithjes së donacioneve në zhvillimin e FSK-së. Z. Christensen premtoi ta ndihmojë FSK-në, në këtë drejtim. Konferenca ,,Lansimi i Planit të Integritetit të MFSK-së, i përmbylli punimet me sesionin e pyetjeve dhe përgjigjeve nga panelistët.

MFSK-ja finalizoi Planin e Integritetit


Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës më 8 qershor 206, u zhvillua konferenca për finalizimin e "Planit të Integritetit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë', projekt ky i mbështetur nga Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë. Në këtë takimin u prezantua drafti final i Planit të Integritetit. Takimi u kryesua nga sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, drejtori për Politika dhe Plane, Faruk Geci, drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë(QKSS), Florian Qehaja. Plani i Integritetit është dokument strategjik dhe operativ që mbështetë me prova rezultatet e procesit sistematik të vlerësimit të rrezikut të integritetit të ndërmarra brenda organizatës. Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit është forcimi i integritetit dhe forcimi i kulturës kundër-korrupsion në sektorin publik duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate.

Ministri Demolli falënderoi ambasadorin e Hungarisë në Kosovë Laszlo Markusz



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), zoti Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramën më 28 qershor pritën në një takim zyrtar ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, z. Laszlo Markusz dhe sekretarin e parë të Ambasadës së Hungarisë në Prishtinë, z. Imre Vekas Kovacs, para se ky i fundit të largohet nga Kosova. Me këtë rast, ministri Demolli falënderoi ambasadorin Markusz dhe sekretarin Kovacs për ndihmën që Hungaria ka dhënë ndër vite dhe po vazhdon të jep për FSK-në, e në veçanti ministri shprehu mirënjohjen e tij për bashkëpunimin e mirë në mes dy shteteve dhe dy ministrive përkatëse, si dhe për kontributin e tij personal rreth përgatitjes dhe nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë, që u nënshkrua këtë muaj, më 10 qershor 2016, në Budapest, në mes dy ministrave. Nga ana e tij, ambasadori i Hungarisë në Prishtinë, z. Markusz, falënderoi ministrin Demolli për pritjen, si dhe vlerësoi lart bashkëpunimin e ndërsjellë, duke u shprehur i kënaqur me thellimin e këtij bashkëpunimi. Gjithashtu ministri Demolli falënderoi edhe sekretarin e parë të ambasadës së Hungarisë në Kosovë, z. Imre Kovacs, para se ky të largohet nga Kosova. Me këtë rast, ministri Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, sekretarit të parë të ambasadës së Hungarisë, z. Kovacs i dhanë mirënjohje; Certifikatë falënderimi, për punën dhe angazhimin e tij, rreth thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive; MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë.

Ministri Demolli priti këshilltarin suedez të NATO-s për MFSK



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli, më 8 qershor 2016, priti në zyrën e tij këshilltarin për Politika dhe Plane, Transformim, Standardizim dhe Modernizim, si dhe këshilltarin për Marrëdhënie Ushtarako-Civile në MFSK, këshilltar në kuadër të Ekipit Këshillues të NATOS për MFSK-në(NAT), komandant në marinë, Bjorn Nilso. Me këtë rast ministri Demolli e falënderoi oficerin suedez të NAT-it, zotëri Bjorn Nilso për shërbimin e tij dymbëdhjetë mujor në Kosovë, si dhe për kontributin dhe mbështetjen që Ai dha në ndërtimin e vazhdueshëm të Ministrisë dhe të FSK-së. Më tej ministri Haki Demolli tha se: ,,Ju keni luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e Ministrisë sidomos mbështetjen në krijimin e Departamentit të Transformimit, Modernizimit dhe Standardizimit, pastaj këshillimet për Departamentin për Politika dhe Plane si dhe atë të Marrëdhënieve Ushtarake-Civile në MFSK. Me rastin e këtij takimi lamtumirës, ministri Demolli i dhuroj komandantit Bjorn Nilso një Certifikatë-mirënjohje, si shpërblim për punën, angazhimin dhe kontributin e tij gjatë shërbimit në Kosovë. Në fund, Ministri Demolli ha se: ,,puna juaj në formulimin e koncepteve, politikave dhe proceseve të planifikimit ka çuar ministrinë tonë në rrugë të drejtë për të ardhmen". Ministri Demoli duke iu drejtuar oficerit Nilso, tha se, keni punuar shumë dhe keni shpërndarë njohuri dhe keni venë në dispozicion eksperiencën tuaj me stafin tim, të cilët kanë përfituar shumë nga këshillat tuaja, duke falënderuar me këtë rast edhe Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Suedisë për ndihmën që ajo i ka ofruar Ministrisë dhe vendit tonë në përgjithësi.

Gjenerali amerikan Timothy Orr vizitoi njësitet e FSK-së



Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës (SHBA) gjeneral majori Timothy Orr, gjatë qëndrimit në Kosovë, nga data: 29. 06. 02. 07. 2016, realizoi vizita pune në të gjitha njësitet e FSK-së. Gjenerali Orr shoqërohej nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, atasheu ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë-koloneli Anthony Butts dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Gjenerali Orr gjatë pjesëmarrjes në ceremoninë e diplomimit të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, 1 korrik 2016, që u mbajt në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, përgëzoi kadetët e QSU-së, për suksesin e treguar gjatë katër vjetëve të studimeve. Duke iu drejtuar kadetëve, Ai tha: "Kosova dhe Ajova janë krenar me ju. Për mua është nderë që gjendem prapë në Kosovë, në diplomimin e juaj. Te Ju, unë shohë drejtues me integritet dhe shërbyes shembullor. Ju keni punuar shumë përgjatë katër vjetëve, që të arrini sot këtu, dhe të merrni gradën e nëntogerit. Ju sot e keni bërë krenare tërë Kosovën. Ju jeni më të mirët e më të mirëve që ka Kosova. Para së gjithash mbani mend, vendi juaj ka investuar kohë, para dhe udhëheqje që ju të arrini këtë pikë të karrierës ushtarake" tha në fund të fjalës së tij, gjenerali Orr. Ndërsa, më 29.06.2016, gjenerali Orr, së bashku me gjenerallejtënant Rrahman Ramën, realizuan vizita pune në të gjitha njësitet e FSK-së, ku nga komandantët e tyre, u njoftua me arritjet e përgjithshme, si dhe me sfidat me të cilat po përballen Njësitet e tyre. Në Komandën e Forcave Tokësore delegacioni i SHBA-ve u prit nga shefi i Shtabit kolonel Naim Haziri i cili i njoftoi ata, me procedurat e udhëheqjes me njësitet, si dhe me rrjedhën e informacioneve të operacioneve të cilat i kryen Forca e Sigurisë së Kosovës. Ndërsa, në Brigadën e Mbështetjes Operacionale dhe në Regjimentin e Mbrojtjes Civile delegacioni amerikan u prit nga shefi i Shtabit të BMO-së, nënkolonel Agron Bajrami dhe komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri. Me këtë rast, gjenerali Orr u njoftua me të arritura e përgjithshme të KFT-së, BMO-së dhe RMC-së. Ai, gjithashtu përgëzoi FSK-në, për përparimet dhe të arritur në të gjitha fushat, duke vlerësuar lartë bashkëpunimin e shkëlqyer dhe partneritetin që ka Garda Kombëtare e Ajovës me FSK-në.Më 30 qershor 2016, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës qëndroi në Brigadën për Reagim të Shpejtë në Istog dhe Batalionin e Tretë të BRSH-së në Mitrovicë. Ai ka përgëzuar komandantin e BRSH-së, për punën dhe angazhimet e vazhdueshme që po bëjnë në ngritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në një forcë profesionale dhe me standardet më të larta. Me këtë rast, gjenerali Orr, përgëzoi toger Manushaqe Nurën për rezultatet e arritura në garat ndërkombëtare dhe tetar RafetGashin për garat vendore, me "Kupën e Kampit të Gardës Nacionale të IOWAS".Kurse, në Qendrën Operative të Batalionit të 3-të, gjenerali Orr u njoftua hollësisht me planifikimin e ushtrimit të ardhshëm fushorë si dhe përcolli trajnim e



Kompanisë 3C, e cila është në fazën e trajnimit në kuadër të gjenerimit të forcës. Komandant i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci e falënderoi gjeneralin Orr, për ndihmën që Ushtria Amerikane ka dhënë dhe po jep për FSK-në, në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të saj, përmes trajnimeve dhe donacioneve të ndryshme. Kolonel Geci më pastaj i njoftoi mysafirët me aktivitetet e përgjithshme të BRSH-së, duke u fokusuar në trajnimet që BRSH-ja, po i realizohen në bashkëpunim të plotë me Ushtrinë Amerikane të Shtetit IOWA. Kjo dhe vizitat tjera të komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës janë vazhdimësi e bashkëpunimit të FSK-së me Gardën Kombëtare të IOWA-s. Për nder të vizitës së delegacionit amerikanë, Kompania 2B e Batalionit të Dytë të BRSH-së, demonstroi disa pika nga patrullimi me autoblinda dhe reagimi në kontakt. Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjatë vizitave në të gjitha njësitet e FSK-së, përmes prezantime, nga shefat e shtabeve u njoftua gjerësisht për organizimin e brendshëm, punët dhe detyrat të cilat janë duke i zhvilluar, të arriturat e përgjithshme, misionin, trajnimet, shkollimet dhe angazhimet në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Gjenerali Orr, përgëzoi komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën si dhe komandantët e njësiteve dhe oficerët dhe nënoficerët e FSK-së, për arritje e tyre profesionale, si dhe premtoi mbështetje në zhvillimin e liderëve të rinj, me qëllim të ngritjes dhe mirëmbajtjes së kapaciteteve aktuale operacionale.





Ministri Demolli dhe gjeneral Rama pritën komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralin Timothy Orr





Ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 28 qershor pritën në takime të ndara komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës (SHBA), gjeneralin Timothy Orr me bashkëpunëtorë. Ministri Demolli falënderoi komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës për ndihmën që SHBA-të po japin për Kosovën e në veçanti për FSK-në. Me këtë rast, ministri Demolli vlerësoi lart bashkëpunimin e mirë dhe intensiv të FSK-së, me Gardën Kombëtare të Ajovës, e cila përmes programit të 'Partneritetit për Paqe' po e ndihmon FSK-në në ngritjen profesionale dhe infrastrukturore; si në fushën e trajnimeve, edukimit, donacioneve, programeve të veçanta dhe këshillimeve.
Më tej, ministri Demolli e njoftoi komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe rreth procesit të transformimit të FSK-së. Nga ana e tij edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, e falënderoi komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralin Timothy Orr, për ndihmën e vazhdueshme të SHBA-ve për FSK-në, duke çmuar veçanërisht kontributin e instruktorëve të Gardës Kombëtare të Ajovës në ngritjen profesionale të FSK-së. Nder të tjera, ministri Demolli dhe gjeneral Rama biseduan me gjeneralin Orr edhe për rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve si dhe për format e reja të bashkëpunimit edhe në fushat tjera. Nga ana e tij, komandanti i Gardës Kombëtare gjenerali Timothy Orr, falënderoi ministrin Demolli dhe gjeneralin Rama për pritjen si dhe vlerësoi lartë bashkëpunimin me FSK-në, duke u shprehur se ndjehet shumë krenar me këtë bashkëpunim.
Gjenerali Orr premtoi, edhe në të ardhmen, vazhdimin e bashkëpunimit më intensitet edhe më të madh të Gardës që ai drejton me FSK-në. Në takim ishin të pranishëm edhe zëvendësministrat Gashi dhe Latifi, koloneli Ilir Qeriqi-drejtor i Drejtorisë për Sigurim dhe Bashkëpunim i MFSK-së, atasheu ushtarak i SHBA-ve në Prishtinë, koloneli Anthony Butts, nënkoloneli Michael Wunn-drejtor i Programit të Partneritetit Shtetëror, majori Jodi Marti dhe rreshteri Rachel Fails, koloneli Fadil Hadërgjonaj-këshilltar ushtarak i ministrit, shefi i Kabinetit të Ministrit Latif Leka dhe ish-atasheu ushtarak i FSK-së në SHBA, gjeneral brigade Xhavit Gashi.

FSK-ja në ushtrimin fushor „Shpata e argjendtë" teston aftësitë në raste krizash me refugjatë



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant RrahmanRama dhe komandanti i KFOR-it, gjeneral major GuglielmoLuigiMiglieta, më 3 qershor 2016,
zbritën sot me helikopter në zonën e operacionit të ushtrimit fushor „Shpata e argjendtë" në kazermën e FSK-së „Evropianët e rinj" në Pomozotin, për të parë nga afër operacionet përfundimtare të ushtrimit të përbashkët të institucioneve të sigurisë në vend, si FSK, KFOR, Policia e Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të zhvilluar nga data 1 derë më 3 qershor 2016.
Demonstrimet e aktiviteteve të ushtrimit fushor i përcjellën nga afër edhe zëvendësministrat, ai i FSK-së Fadil Gashi dhe ai i Punëve të Brendshme, Valdet Hoxha; sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj; komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale, kolonel Muharrem Rrahmani; komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes civile(RMC), kolonel Shaip Haziri; komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë(BRSH), kolonel Xhevahir Geci; përfaqësues të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, si dhe oficerë të FSK-së, KFOR-it dhe të Policisë së Kosovës.
Fillimisht në zonën e operacionit u bë një prezantim i tërë procesit të planifikimit, ku u prezantua skenari, aktorët, institucionet dhe njësitë pjesëmarrëse në realizimin e këtij ushtrimi, dhe më pas u vizituan edhe vend-incidentet e ushtrimit.Me këtë rast komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovë, gjenerallejtënant RrahmanRama, pasi përcolli të gjitha aktivitetet e ushtrimit u shpreh se: „ Nga ajo që pamë sot këtu, mund të them se ushtrimi „Shpata e argjendtë" doli të jetë pikërisht ashtu siç ishte planifikuar, një test dhe sprovë e suksesshme e menaxhimit të emergjencave dhe krizave eventuale në vend, e gjithashtu një ushtrim i veprimit dhe ndërveprimit të suksesshëm dhe i realizuar bashkërisht me të gjitha institucionet e sigurisë që veprojnë në Kosovë". Gjeneral Rama falënderoi KFOR-in, ekipet këshilluese të NATO-s, agjencitë tjera vendore pjesëmarrëse në ushtrim, e në veçanti oficerët, nënoficerët dhe ushtarët që për tri ditë rresht do të realizojnë me përpikëri dhe motiv të lartë të gjitha detyrat e parashtruara.Sipas skenarit, refugjatët e supozuar kishin ardhur nga Siria nëpërmjet Republikës së Maqedonisë dhe po kalonin zonën kufitare Kosovë- Maqedoni, ku fillimisht u legjitimuan, intervistuan nga Policia e Kosovës, pastaj rastet me sëmundje apo lëndime u trajtuan nga ekipet mjekësore të FSK-së, përkatësisht Kompanisë së Mjekësisë dhe ato të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave.
Po sipas skenarit, refugjatët pas legjitimimit, intervistimit dhe procedurave tjera ligjore transportohen nga Policia e Kosovës për në kampet e refugjatëve të ngritur dhe menaxhuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Vlen të theksohet gjithashtu se ekipet e FSK-së, përkatësisht kërkim- shpëtimit dhe ato të deminimit gjithashtu kanë qenë të angazhuar në kërkimin eventual për persona të zhdukur apo persona që kanë humbur rrugën në zonën kufitare, ndërsa ekipet e deminimit dhe ekipet për eliminimin e mjeteve të pashpërthyera gjatë gjithë kohës qenë të angazhuara për zbatimin e misionit të tyre sipas skenarit të ushtrimit.Ushtrimi fushor „ Shpata e Argjendtë"kishte për qëllim testimin e aftësive ndërvepruese të institucioneve të sigurisë në Kosovë për menaxhimin e emergjencave dhe krizave me rastin e ardhjes eventuale të refugjatëve, si dhe testimin e mbështetjes humanitare për refugjatë.

Ministri Demolli priti në takim lamtumirës nënkolonel Viktor Nikollën, këshilltar i NATO-s për Ministrinë e FSK-së

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli, më 15 qershor, priti në takim lamtumirës, si dhe i dorëzoi një ,,Certifikatë Mirënjohje" këshilltarit të NATO-s për Inteligjencë dhe Siguri, në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(NAT), nënkolonel Viktor Nikolla. Me këtë rast, Ministri Demolli, në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës e falënderoi nënkolonelin Nikolla për përkushtim dhe angazhimin e tij në punë, gjatë realizimit të detyrës së tij si Këshilltar i NATO-s, për Inteligjencë dhe Siguri në Ministrinë për Forcën e Sigurisë. Më tej, Ministri i FSK-së, z. Demolli u shpreh se:,,Nënkoloneli Nikolla, gjatë një viti qëndrimi këtu, ka dhënë një kontribut të çmuar në MFSK, në fushën e Inteligjencës dhe Sigurisë", dhe me këtë, shtoi: ju keni kontribuar në zhvillimin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në fund të takimit lamtumirës, Ministri Demolli tha:"Ekipi Këshillues i NATO-s, në përgjithësi ka dhënë dhe po vazhdon të jap një kontribut të çmuar në rrugën e zhvillimit të Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë. Nga ana e tij, nënkoloneli Nikolla, ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i angazhuar në kuadër të Ekipit Këshillues të NATO-s për Ministrinë, u shpreh i lumtur që puna e tij këtu është vlerësuar dhe gjithashtu tha se ndjehet i lumtur që edhe ai profesionalisht pati mundësinë të jap një kontribut në këto kohë kur Republika e Kosovës po konsolidon seriozisht institucionet më vitale të shtetit, dhe se Ai për një vit ka kontribuar për MFSK-n, së bashku edhe me ushtarak të shteteve tjera anëtare të NATO-s.



Në Brigadën për Reagim të Shpejtë u realizua trajnimi "Organizimi i mirëmbajtjes së automjeteve dhe pajisjeve"

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadëssë Reagimit të Shpejt (BRSH) në Istog, më 10 qershor 2016, u realizua trajnimi njëditor ,,Organizmi i Mirëmbajtjes së Automjeteve dhe Pajisjeve ", në kuadër të bashkëpunimit që ka FSK me Ushtrinë e Republikës së Gjermanisë, e në veçanti për faktin se Brigada për Reagim të Shpejtë është zgjedhur si shembull i mirë i organizimit dhe funksionimit. Për të parë nga afër mbarëvajtjen e trajnimit, në BRSh



qëndruan edhe gjeneral brigade ZymerHalimi, komandanti i Brigadës për Reagimit të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, përfaqësues të Departamentit të Logjistikës të MFSK-së dhe KFT-së, këshilltari ushtarak për çështje të logjistikës në MFSK nga ushtria gjermane, nënkolonel MichaelGierse, përfaqësues nga Ekipi Ndërlidhës Këshillues i NATO-s për MFSK-në(NLAT), shefi i Shtabit, major EjupMaqedonci, komandantët e batalioneve të BRSH-së, shefat e logjistikës të batalioneve, përfaqësues të sektorëve të logjistikës nga njësitet e Brigadës për Mbështetje Operacionale(BMO), Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS) dhe Regjimenti i Mbrojtjes Civile (RMC) . Me këtë rast, kolonel Geci foli për rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm që ka FSK-ja me Forcat e Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë dhe kontributin që këta të fundit kanë dhënë në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së në fushën e logjistikës. Ndërsa sa i përket trajnimit ,,Organizimi i Mirëmbajtjes së Automjeteve dhe Pajisjeve", kolonel Xhevahir Geci tha se: ,,Logjistika është një ndër fushat më të rëndësishme për funksionimin dhe operacionalitetin e Forcës tonë. Për të funksionuar ky sektor në mënyrë sa më të mirë nevojitet një planifikim i mirëfilltë dhe një punë e palodhshme në ndërtimin e një sistemi të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe automjeteve. Prandaj, qëllimi i trajnimit të sotëm është që të ju informojmë se si funksionon sistemi i mirëmbajtjes së pajisjeve dhe automjeteve në BRSH dhe gjithashtu së bashku të diskutojmë sfidat me të cilat ballafaqohet ky sektor dhe opsionet se si t'i zbusim këto sfida. Më pas për të pranishmit, shefi i Shtabit të BRSh-së major EjupMaqedonci dhe shefi i Logjistikës së BRSh-së major Arbnor Zeneli, prezantuan mënyrën e organizimit dhe funksionimit të mirëmbajtjes së automjeteve dhe pajisjeve në BRSh. Pastaj edhe këshilltari ushtarak në fushën e Logjistikës në MFSK nga ushtria gjermane, nënkoloneli MichaelGierse, prezantoi mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të mirëmbajtjes në Forcat e Armatosura të Republikës së Gjermanisë. Nënkolonel Gierse tha gjithashtu se: ,,Shkëmbimi i përvojave ndërmjet FSK-së dhe në ketë rast Forcave të Armatosura të Republikës së Gjermanisë është në interes të zhvillimit dhe avancimit të nivelit operacional të FSK-së në fushën e logjistikës". Gjatë gjithë prezantimeve nga pjesëmarrësit është vërejtur një interesim i madh rreth asaj që BRSh -ja ka arritur të menaxhojë dhe të zhvillojë, një sistem funksional të mirëmbajtjes së automjeteve dhe pajisjeve, ku janë diskutuar çështje të rëndësishme dhe janë dhënë rekomandime për ngritjen edhe me shumë të nivelit opracional në fushën e logjistikës në FSK. Pas përfundimit të prezantimeve, të gjithë pjesëmarrësit vizituan punëtorinë për servisimin e automjeteve në BRSh dhe depon e pjesëve rezervë ku u njoftuan në mënyrë të drejtpërdrejtë me funksionimin e mirëmbajtjes së automjeteve dhe pajisjeve në BRSh. Në komentet e tij përmbyllëse, gjeneral brigade Zymer Halimi theksoi se; " Ju si BRSh keni bërë një punë të madhe dhe nga kjo të gjithë mund të marrim mësim. Njëra nga objektivat e KOMFSK-së është edhe vet-qëndrueshmëria e njësive, por gjithherë ka hapësirë për avancim të mëtutjeshëm. Të gjeturat nga kjo punëtori të aplikohen edhe në njësitë e tjera, sepse shembullin e mirë duhet ta marrin edhe të tjerët dhe ta praktikojnë në njësi. Organizime të tilla priten të realizohen edhe në njësitë e tjera të FSK-së".

Në FSK përfundoi "Kampi Rinor 2016" i nxënësve të shkollave të mesme

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së në Ferizaj, më 3 qershor u mbajt ceremonia përmbyllëse e "Kampit Rinor 2016", ku u certifikuan 97 nxënës të shkollave të mesme të Kosovës, të cilët morën pjesë nga data: 30.05 deri më datë 03.06.2016. Në ceremoni ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, shefi i Shtabit të KDS-së, nënkolonel Fadil Hoxha, drejtori i Departamentit të BCU-së, z. Hajrush Kurtaj, nënkolonel Afrim Veseli, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. N ë fjalën e tij, drejtori i BCU-së, z. Kurtaj i përgëzoi nxënësit për angazhimin dhe sjelljen e tyre gjatë qëndrimin njëjavor në ,,Kampin Rinor 2016". Ai, përveç tjerash, kërkoi nga nxënësit kampist që përvojën e fituar gjatë qëndrimit në këtë kamp ta ndajnë me kolegët e tyre në shkollat ku ata mësojnë. Më pas, z. Kurtaj, nxënësve pjesëmarrës të këtij kampi ua dhuroi nga një ekzemplar të librit "Lufta e UÇK-së në ZON", autor i së cilës është vet. Ndërsa, në emër të KDS-së, shefi i Shtabit të KDS-së, nënkolonel Fadil Hoxha, i përgëzoi dhe i falënderoi nxënësit për sjelljen dhe qëndrimin shembullor, si dhe për angazhimin e tyre për t'u pajisur



me njohuri të përgjithshme lidhur me detyrat dhe rolin e FSK-së. Ai, ndër të tjera, tha: "Të rinjtë janë pasuria më e çmuar e Kosovës dhe ne presim që disa nga ju në kohën kur të mbushni moshën të aplikoni dhe të bëheni pjesë e Forcës së Kosovës. Ne shpresojmë se programi i zhvilluar me ju ka ndihmuar mjaftueshëm për të marrë informacionet bazë se si organizohet jeta e brendshme në një kazermë dhe çfarë vlera dhe virtyte duhet të ketë një ushtarak". Gjatë qëndrimit në kazermën e FSK-së, nxënësit u njoftuan nga oficerët ligjërues edhe me disa tema të tjera, si: orientimi në natyrë, rreshtimet, kultura ushtarake, si dhe zhvilluan aktivitete të shumta sportive."Kampi Rinor 2016", është mbajtur nen organizimin e Departamentit Civilo-Ushtarak të MFSK-KFT-së në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, përkatësisht me drejtoritë komunale të arsimit, i cili tashmë është bërë pjesë e planit të punës për KDS-në.





Kadetët e FSK-së me sukses mbajtën ushtrimin fushor "Kampi veror 2016" në Zhegoc të Gjilanit

Qendra e Studimeve Universitare(QSU) e Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), më 17 qershor 2016, realizoi me sukses ushtrimin fushor "Kampi veror 2016" në Zhegoc të Gjilanit. Në ushtrim janë të përfshirë të gjithë kadetët e QSU-së, si dhe nga një ekip nga Policia e Forcës dhe nga Kompania e Mjekësisë, të cilët do përkujdesën në rast të lëndimeve eventuale të kadetëve. Për të përcjellë nga afër mbarëvajtjen e këtij ushtrimi janë të pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), kolonel Irfete Spahiu, drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s për FSK-në(NLAT), gjeneral brigade Ernst Horn, komandanti i Kampit ,,Bondstell", kolonel Gammom, komandanti i Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BAT1), nënkolonel Haki Xhemajli si dhe eprorë tjerë të lartë të FSK-së. Komandanti i QSU-së, major Avni Kiçina mbajti një takim informues rreth mbarëvajtjes, ecurisë dhe qëllimit të këtij ushtrimi dyjavor të kadetëve të kësaj Qendre, me ç 'rast theksoi se i gjithë qëllimi i këtij ushtrimi fushor është vlerësimi i kadetëve për shkencat ushtarake për vitin 2015-2016.
Ndërsa, një fjalë rasti para kadetëve dhe të pranishmeve e mbajti dhe zv. komandanti i KFT-së gjeneral Hazrolli, i cili pasi falënderoi të gjithë të pranishmit i përgëzoi kadetët edhe për angazhimin e treguar gjatë këtyre ditëve, duke shtuar se "Duhet realizuar synimin të cilin e keni para vetës, në krijimin e liderëve me vetiniciative, andaj kërkoj nga ju që të shfrytëzoni këtë mundësi të mirë për të përfituar nga eksperiencat e mëdha të mbështetësve tanë nga Brigada Shumëkombëshe Jug si dhe nga oficerët tanë më përvojë disavjeçare para dhe pas lufte". Më pas gjatë fjalës së tij, gjeneral Hazrolli theksoi se " Ne si institucion i vogël vetëm më vlera mund të konkurrojmë dhe të jemi përkrah aleatëve tanë". Ndërkaq, komandanti i Kampit Bondsteel, kolonel Gammom iu drejtua instruktorëve me fjalët" Njëzet e nëntë vite më parë e kujtoj një ditë si kjo, kur unë isha kadet, nga ajo kohë kujtoj fjalët dhe punën e mirë të instruktorëve që kanë bërë me ne, edhe këta kadetë do të kujtojnë për tridhjetë vite të ardhshme punën e mirë që ju keni bërë si ekip". Në fund, kadetët demonstruan disa nga aktivitetet e tyre që nga faza e planifikimit për të pranishmit.

27 nënoficerë përfunduan "Kursin e Avancuar për Lider"

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), më 6 qershor 2016, u mbajt ceremonia e certifikimit të nënoficerëve të cilët përfunduan me sukses ,,Kursin e Avancuar për Lider". Në këtë ceremoni morën pjesë zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, shefi i Shtabit të KDS-së, nënkolonel Fadil Hoxha, zëvendëskomandanti i Bondstillit nënkolonel Wegscheider, oficerë dhe nënoficerë të KDS-së dhe të Bondstillit. Me rastin e ceremonisë së certifikimit, kolonel Irfete Spahiu, në emër të KDS-së, i përshëndeti të pranishmit si dhe i përgëzoi instruktorët dhe personelin për organizimin, përkushtimin dhe realizimin e këtij kursi, të cilin e vlerësoi si mjaft sfidues dhe të rëndësishëm për nënoficerët të



cilët synojnë të jenë lider në punën dhe organizimin e tyre nëpër njësitë e FSK-së. Ajo, ndër të tjera gjatë fjalës së saj, tha se ky kurs është projektuar me qëllim që t'i ndihmojë nënoficerët në zhvillimin e elementeve të cilat u mundësojnë kalimin e aftësive dhe përgjegjësive individuale në aftësi e përgjegjësi kolektive, duke i zhvilluar dhe përgatitur pjesëmarrësit për rolin drejtues të nënoficerëve në radhët e FSK-së.
"Programi i kursit u ofron nënoficerëve të FSK-së, shkathtësi të nevojshme për të kryer punët e tyre si nënoficerë të FSK-së, rrënjos tek NOF-a vlerat e FSK-së, rrit dhe zhvillon shkathtësitë e dëgjimit dhe komunikimit duke rritur kësisoj administrimin dhe udhëheqjen në të gjitha njësitë e FSK-së". Kolonel Spahiu u ndal edhe te bashkëpunimi dypalësh dhe ndihma e madhe nga kampi amerikan i Bondstillit, e cila siç tha ajo ka përforcuar edhe më shumë aftësitë e pjesëtarëve tanë ngase ata kanë qenë përkrahë jush në rritjen dhe avancimin tuaj si NOF. Pjesëmarrja e tyre në ushtrimin fushor ka treguar edhe njëherë dëshirën e madhe të miqve tanë për avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të kanalit mbështetës të NOF të FSK-së, duke qenë përkrahësit tanë kryesorë në çdo hap që ne bëjmë. Rreshter majori i Komandës së Kampit Bondstill CSM Hileman u fokusua te roli dhe rëndësia e nënoficerit e sidomos te kanali mbështetës, ku foli në përgjithësi se çfarë roli luan NOF-a në ushtri. Kursi i Avancuar për Lider tha se është bazë e fortë për të zhvilluar NOF-Lider, ndërsa sa i përket angazhimit të pjesëtarëve të FSK-së, tha se ka mbetur i mahnitur me përkushtimin e tyre në arritjen e rezultateve gjatë tërë procesit të stërvitjes. Në emër të shkollës foli kapiten Arben Avdyli i cili ndër të tjera u shpreh: "Njësitë e Forcës së Sigurisë të Kosovës përzgjedhin nënoficerët e tyre, për pjesëmarrje në këtë kurs, duke u bazuar në aftësitë e tyre të demonstruara për të ngritur pozitat udhëheqëse si nënoficerë profesionistë. Ky është një kurs shtatë (7) javor, me një program të ngjeshur, mjaft stresues por i dobishëm."
Kursin e kanë përfunduar 27 nënoficerë të njësive të FSK-së dhe është realizuar me sistemin e kombinuar teori dhe praktikë. Në fund, për përfundimin me sukses të kursit, për pjesëmarrësit u ndan certifikata.

Me nderime të larta ushtarake varroset rreshter Ahmet Menxhiqi

Pjesëtari i FSK-së, rreshter Ahmet Menxhiqi, më 6 qershor 2016, pas një sëmundje të rëndë, ndërroi jetë në Gjermani, ndërsa më 9 qershor 2016, varroset me nderime në fshatin Sfaraçak të Vushtrrisë. Në ceremoninë e varrimit ishin prezent ministri i FSK-së, Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kryetari i Vushtrrisë Bajram Mulaku, gjeneral brigade Zymer Halimi drejtor i Drejtorisë së Operacioneve në Ministrinë për FSK-në, kolonel Xhevahir Geci, komandant i Brigadës për Reagimit të Shpejtë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, oficerë, nënoficerë dhe ushtarakë të FSK-së, kolegë e bashkëpunëtorë, familjarët e rreshterit si dhe qytetarë të shumtë nga Vushtrria, Mitrovica dhe Kosova. Në emër të FSK-së, ngushëllimet familjes dhe gjithë pjesëmarrësve në varrim u shprehu komandanti i Batalionit të Tretë të BRSH-së, major Beton Retkoceri.,, Ahmet Menxhiqii kushtoi një jetë të tërë çështjes kombëtare, lirisë së vendit tonë si dhe ndërtimit dhe ecjes përpara. Dëshira e rreshter Ahmet Menxhiqit për të kontribuar në ndërtimin e themeleve të Ushtrisë së ardhshme të Republikës së Kosovës u bë realitet në vitin 2009. Gjatë gjithë këtyre viteve të shërbimit në FSK, Ahmeti ishte shembull për të tjerët, për angazhimin e tij në ndërtimin e kapaciteteve ushtarake të Forcës sonë. Ai ishte bërë shembull për punëndhe për energjinë që kishte në realizimin e detyraveushtarake."tha në fund majori Retkoceri. Në emër të KK të Vushtrrisë, nënkryetari Dibran Perquku shprehu ngushëllimet më të sinqerta familjes, FSK-së dhe të gjithë bashkëluftëtarëve. Z. Perquku vuri theksin tek vlerat të cilat i posedonte Ahmeti dhe familja e tij, të cilët brez pas brezi nuk u dorëzuan por u bënë ballë gjithmonë furtunave gjatë historisë. "Ahmeti patriotizmin dhe shpirtin liridashës e kishte trashëguar nga të parët e tij brez pas brezi dhe gjatë luftës nuk kurseu asgjë për çlirimin dhe ndërtimin e shtetit u shpreh ai. Ndërsa në emër të shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dega në Vushtrri, foli Bajram Beqiri, i cili e theksoi aktivitetin e Ahmet Menxhiqit në luftën për çlirim duke qenë pjesëtar i dalluar i Brigadës 141 të UÇK-së, Zona Operative e Shalës. Edhe pse në moshë të re, Ahmeti u shqua për disiplinën dhe shpirtin luftarak duke marrë pjesë në shumë beteja deri në çlirimin e vendit. Ndërsa,



vajza e Ahmetit, Donjeta, me lot në sy, recitoj një poezi që ia kishte kushtuar babit; edhe pse emocionet e bën të veten, ajo qëndroi krenare para trupit të babait duke interpretuar poezinë e saj plot emocion dhe krenari për babanë e humbur në moshë të re. Në emër të familjes Menxhiqi, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në përcjelljen e fundit të Ahmetit i vëllai Musa Menxhiqi. Në fund u bënë homazhe dhe u vunë kurora lulesh nga KOM i FSK-së, oficerë e nënoficerë, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, bashkëluftëtarë e familjarë të shumtë. Ahmet Menxhiqi ka ndërruar jetë pas një sëmundje të rëndë, më 6 qershor 2016, në Gjermani. Ai pas vetës ka lënë prindërit, bashkëshorten dhe tre fëmijë.

FSK-ja dhe FASH luajtën baras 1:1

Ekipi i futbollit i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe ai i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) luajtën barazi (1:1) në ndeshjen që u zhvillua më 20 qershor, në Garnizonin ,,Skënderbej"në Tiranë.Për të parë nga afër ndeshjen, në mes të ushtarakëve të dyja shteteve, në Tiranë qëndruan edhe ministri i Mbrojtjes i Kosovës, z. Haki Demolli, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Muhamet Latifi dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Pas ekzekutimit të himneve kombëtare, ekipet e futbollit janë përshëndetur nga ministri i Mbrojtjes z. Demolli dhe gjenerali Jeronim Bazo, shef i Shtabit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, të cilët u kanë uruar suksese dhe fitore në këtë ndeshje si dhe kanë shprehur kënaqësinë e përbashkët që ndjejnë edhe në këtë aktivitet sportiv. Ndeshja, e cila ka përfunduar me rezultatin barazim 1-1, është shoqëruar në pushim të saj nga një koncert i grupi muzikor të Shtabit të Përgjithshëm, i cili rriti më tepër entuziazmin e ndeshjes. Gjeneral Bazo i dhuroi kupën e garës kapitenit të FSK, pasi që kupën e mori ekipi i FSK, sepse shënoi gol në fushën kundërshtare, ndërsa ministri Demolli i dhuroi kupën e lojtarit më të mirë, futbollistit ushtarak nga FA të RSH, Gazmend Gashit. Ekipi i futbollit i Forcës së Sigurisë së Kosovës drejtohet nga trajneri Afrim Nebihu, ndërsa ekipi shqiptar u përgatit dhe drejtua nga kapiten Emiliano Ndoni, specialist për përgatitjen fizike në Drejtorinë e Operacioneve dhe Stërvitjes, në Shtabin e Përgjithshëm të FA dhe trajner, toger Enkele Likaj. Ky aktivitet i shërben forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe midis Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, në



kuadër të bashkëpunimit dypalësh. Ministri Demolli, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ndanë mendimin e njëjtë për zgjerimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen, krahas fushave të tjera.






Intervistë me toger Mimoza Budeci trajnere e Klubit të futbollit (të femrave) të FSK-së

FSK-ja e para në turneun e futbollit në Klinë

Gazeta ,,Forca Jonë"; *Kur është themeluar ekipi i futbollit për femra në FSK?*

Toger Mimoza Budeci: Ekipi i futbollit të femrave është themeluar gjatë vitit të kaluar, gjegjësisht në korrik të vitit 2015. Ideja për themelimin e një klubi të futbollit për femra lindi si rezultat i dëshirës së madhe te vajzave me uniformë për të luajtur futboll. Kjo më ka shtyrë që edhe ne ta kemi një klub futbolli në kuadër të FSK-së. Përveç dëshirës për të luajtur, futbolli kërkon edhe përgatitje të vazhdueshme, gjë të cilën unë si trajnere me licencë ndërkombëtare i kam fituar gjatë trajnimeve që i kam ndjekur, por edhe shumë nga vajzat e ekipit të futbollit janë të përgatitura dhe posedojnë shkathtësi mjaft të mira. Po ashtu është e nevojshme edhe mbështetja institucionale, e cila nuk na ka munguar asnjëherë. Andaj shfrytëzoj rastin të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim për FSK-në, përkrahjen e së cilën e kemi gëzuar në vazhdimësi, po ashtu do të doja të shpreh falënderimin tim edhe për ish-këshilltarin



britanik të komandantit të FSK-së, kolonelin David Jones, për përkrahjen e tij profesionale dhënë ekipeve të FSK-së.

Gazeta ,,Forca Jonë"; *Cilat janë kushtet e punës dhe sa janë të interesuara pjesëtaret e FSK-së për lojën e futbollit?*

Toger Mimoza Budeci: Interesimi për lojën e bukur të futbollit është i madh. Ekipi në total ka 22 lojtare, aq sa duhen për një ekip të futbollit të madh, ndërsa sa i përket kushteve për punë; i shfrytëzojmë hapësirat e ambienteve të kazermës si Sallën e sportive në kazermën "Adem Jashari" dhe terrenet e jashtme. Mund të them që kushtet janë shumë të mira për të realizuar stërvitjet dhe përgatitjen e ekipit për lojë.

Gazeta ,,Forca Jonë": *Cila është pjesëmarrja e ekipit tuaj në gara?*

Toger Mimoza Budeci: ,,Kemi marrë shumë ftesa për të zhvilluar ndeshje miqësore nga ekipe të ndryshme të femrave në nivel vendi. Për shkak të obligime të përgjithshme në kuadër të aktiviteteve të FSK-së, nuk po kemi mundësi t'i realizojmë të gjitha. Por në përgjithësi kemi marrë pjesë dhe po marrim nëpër turne të shumta, siç ishte turneu i futbollit në Komunën e Klinës, me rastin e Ditës së Çlirimit të kësaj komune.

Gazeta ,,Forca Jonë": *Sa jeni e kënaqur me paraqitjen dhe sukseset e ekipit tuaj?*

Toger Mimoza Budeci: Pjesëmarrja në turneun e Klinës, ka pasur karakter garues. Shfrytëzoj rastin të falënderoj kryesinë e Komunës së Klinës për ftesën dhe pritjen. Ekipi i FSK-së në finale është takuar me Ekipin e Klinës, ekip ky i cili garon në Ligën e Parë të Kosovë. Loja e të dyja ekipeve ka qenë shumë e mirë, megjithatë FSK-ja fitoi me rezultat 3:0. Për vendin e parë që zumë u nderuam me Kupë, medalje dhe mirënjohje në përgjithësi.

Gazeta ,,Forca Jonë": *A keni numër të mjaftueshëm të lojtareve?*

Toger Mimoza Budeci: Ekipi i futbollisteve të FSK-së është mjaft premtues, sepse përbëhet nga vajza shumë të zonjat si në punën e tyre ashtu edhe në fushën e futbollit. Vajzat e ekipit tim janë: Donjetë Krasniqi, Liridona Musaj, Kaltrina Ibrahimi, Arditë Guraziu, Kosovare Rashiti, Bjondina Sylejmani, Lavdije Ahmeti, Besarta Pacolli, Kosovare Kuka etj..

Gazeta ,,Forca Jonë": *Toger Budeci, Çfarë mund te na thoni për planet e ekipit tuaj në të ardhmen?*

Toger Mimoza Budeci: Ekipi do të vazhdojë të punojë sipas planit në kuadër të FSK-së. Besoj se edhe mbështetjen dhe përkrahjen e FSK-së do ta kemi si deri më tani. Qëllimi im kryesor është dhe do të mbetet promovimi i frymës ekipore dhe garuese tek vajzat e reja në uniforma të cilat kanë potencialin, karakterin dhe vullnetin për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të përfaqësuar sa më denjësisht uniformën që ato e mbajnë. Për ta mbajtur këtë frymë ne jemi të interesuar që të marrim pjesë në kuadër të Ligës së Kosovës për Femra.

FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 49 • Gusht 2016 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri Haki Demolli priti zëvendësasistentin e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve, Dr. Michael Carpenterin

Ministri i FSK-së, Haki Demolli së bashku me stafin e lartë të Ministrisë dhe FSK-së, priti zëvendës asistentin e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve Mishel Karpenter (Dr Michael Carpenter. Ministri Demolli e falënderoi z. Karpenter për ndihmën që SHBA-të kanë dhënë dhe po japin për FSK-në, e sidomos ai shprehu mirënjohjen e tij të thellë për vendimin dhe kërkesën e Kongresit Amerikan drejtuar administratës amerikane për ta përgatitur dhe ndihmuar Kosovën për anëtarësim në Partneritetin për Paqe. Më pas, ministri Demolli e njoftoi delegacionin e SHBA-ve lidhur me procesin e transformimit të FSK-së, në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK), duke u fokusuar në vështirësitë, sfidat; pengesat dhe vendimet që janë ndërmarrë si ministri dhe qeveri. Ai po ashtu kërkoi edhe ndihmën e SHBA-ve për tejkalimin e këtyre vështirësive. Më tej ministri Demolli ka njoftuar zyrtarin e lartë të SHBA-së për Letrën që Kryeministri i Kosovës Isa Mustafa i ka dërguar NATO-s, me kërkesë të krijimit të dialogut në mes NATO-s dhe Kosovës. Nga zoti Karpenter u kërkua edhe përkrahja e SHBA-ve për anëtarësim me status të plotë në nismat regjionale të sigurisë, siç është Karta e Adriatikut (A-5), ku aktualisht ne kemi statusin e vëzhguesit. Po ashtu në takim u trajtuan edhe tri çështje thelbësore për MFSK-në: Transformimi dhe mbështetja në aspektin e integrimit në iniciativat rajonale, Format dhe intensiteti i bashkëpunimit dypalësh ndërmjet FSK-së dhe SHBA-së dhe Operacionet dhe ushtrimet ushtarake të FSK-së, me theks të veçantë në ushtrimin fushor "Shqiponja-5". Nga ana e tij, zëvendës asistenti i Sekretarit të Mbrojtjes Mishel Karpenter u shpreh se SHBA-ja është mjaft e angazhuar ta ndihmojë Kosovën dhe në veçanti FSK-në, i cili u nda i kënaqur me arritjet e deritashme të FSK-së. Ai po ashtu tha: 'Krahas rezultateve të arritura dhe ndihmës sonë të vazhdueshme, duhet të zhvilloni aktivitete konkrete të planifikuara në vazhdimësi, sepse aktivitetet e vazhdueshme janë garanci e rezultateve. Në fund zoti Karapenter dha një deklaratë për mediave, ku ndër të tjera tha: "Është kënaqësi të jesh në Prishtinë dhe të takohesh me drejtuesit më të lartë të shtetit si me Presidentin, me Kryeministrin dhe Kryetarin e Parlamentit. Tash patëm bashkëbisedim të mirë me min-



istrin Demolli dhe gjeneral Ramën. Ne patën një bisedë të rëndësishme, tashmë veç është e ditur se SHBA mbështetë fuqishëm Kosovën e pavarur demokratike dhe shumetnikë, në këtë drejtim ne mbështesim edhe FSK-në me trajnime, pajisje e këshillime. Ne kemi luajtur rol të rëndësishmen duke përkrahur MFSK-në në hartimin e Rishikimit të Strategjisë së Sektorit të Sigurisë në Kosovë (RSSSK), dhe ne jemi krenar që është punuar në planifikimin e transformimit të FSK-së, që një ditë ajo të jetë Forcë e Armatosur e Kosovës, si forcë që do të mbrojë integritetin dhe sovranitetin e vendit. Ne jemi që i tërë ky proces të shkojë përmes procesit kushtetues dhe ndryshimeve ligjore, sipas meje proces i përgatitur shumë mirë. Ne biseduam sot këtu edhe për intensifikimin e bashkëpunimit në mes të FSK-së dhe SHBA-ve, në veçanti në fushën e ushtrimeve, trajnimeve, shkollimit, bashkëpunimit me Komandën e Ushtrisë së SHBA-së për Evropë dhe posaçërisht me Gardën Kombëtare të Ajovës, në bazë të Programit të Partneritetit Shtetëror i cili është një program i gjerë bashkëpunimi".

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, nga data 22 korrik, qëndroi për një vizitë zyrtare, një javore, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA). Gjatë qëndrimit në SHBA gjenerali Rama vizitoi "Kolegjin e Luftës të SHBA-ve" në Carlisle të Pensilvanisë ku u prit nga komandanti i Kolegjit të Luftës gjeneral major William Rapp me të cilin biseduan për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Gjeneral Rama falënderoi komandantin e Kolegjit Gjeneralin Rapp për ndihmën e vazhdueshme që SHBA-të po japin për Kosovën



dhe në veçanti për FSK-në. Kolegji i Luftës i SHBA-ve, është kolegj prestigjioz i cili edukon dhe zhvillon udhëheqësit për shërbim në nivel strategjik. Qëllimi i "Kolegjit të Luftës të Ushtrisë Amerikane" në këtë kohë dhe në historinë e SHBA-ve, është për të prodhuar lider të diplomuar nga të gjitha kurset e tyre që të jenë mendimtarë të aftë kritik dhe zgjedhjes së problemeve komplekse në zbatimin global të forcave tokësore. Njëkohësisht, e kanë për detyrë që ushtria të veprojë edhe si një "Fabrikë e të menduarit" për komandantët dhe udhëheqësit civil në nivel strategjik në mbarë botën dhe në mënyrë rutinore të angazhohen në diskursin dhe debatin mbi rolin e forcave tokësore në arritjen e objektivave të sigurisë kombëtare. Gjeneral Rama, gjithashtu mori pjesë edhe në ceremoninë e diplomimit të gjeneral brigade Xhavit Gashit në këtë Kolegj Lufte, i cili pas një studimi intensiv këtu, diplomoi me sukses këtu. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama tha se kjo është edhe një fitore në aspektin e shkollimit të kuadrove dhe të ngritjes profesionale të FSK-së. Gjenerallejtënant Rrahman Rama gjatë qëndrimit të tij, zyrtar në SHBA, vizitoi edhe Akademinë Ushtarake "West Point" ku takoi kadetët e FSK-së, të cilët me sukses po shkollohen në këtë akademi prestigjioze amerikane. Ai, me këtë rast ka përgëzuar kadetët: Arlinda Shala dhe ylli Dalladaku, si dhe ka falënderuar Akademinë Ushtarake për ndihmën që po japin në shkollimin e kuadrove të FSK-së.

Ministri Haki Demolli takoi përfaqësuesit e Komitetit të Senatit Amerikan për Shërbimet e Armatosura

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli, më 29 korrik priti në një takim zyrtar përfaqësuesit e Komitetit të Senatit Amerikan për Shërbimet e Armatosura(Senate Armed Services Committee (SASC), në përbërje: Tom Goffus i cili mbulon një fushë të gjerë për Komitetin e Senatit për Shërbimet e Armatosura (KSSHA) duke përfshirë Afganistanin, Pakistanin, Azinë Qendrore, Evropën, Rusinë dhe Lindjen e Mesme, Katie Wheelbarger, drejtor i Shumicës së Politikave dhe Këshilltare për KSSHA(Fokusi i saj është shpesh në çështje të mëdha në luftimin e terrorizmit), Dustin Walker, drejtor i Shumicës në KSSHA dhe Mariah McNamara, nën punës për pakica, mbulon një fushë të gjerë të çështjeve duke përfshirë: bashkëpunimin e sigurisë, Komandën Amerikane për Evropë(EUCOM), NATO-n, Komandën Amerikane të Jugut(SOUTHCOM) si dhe Asistencës Humanitare. **(vijon në faqe-2).**



Ministri Haki Demolli takoi përfaqësuesit e Komitetit të Senatit Amerikan për Shërbimet e Armatosura

(Vijon nga faqja 1)

Në fillim, ministri i FSK-së, Haki Demolli i shprehu përkushtimin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës për sigurinë dhe stabilitetin në vendin tonë si dhe stabilitetin dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë duke u shprehur se: „Ne jemi të gatshëm për të kontribuar për paqen dhe për të mbështetur NATO-n në ruajtjen e paqes në rajon".

Më tej, ministri Haki Demolli e njoftoj delegacionin e Komitetit të Senatit Amerikan për Shërbime të Armatosura mbi zhvillimet në fushën e sigurisë në vend si dhe kërcënimet me të cilat është duke u ballafaquar Republika e Kosovës, duke përmendur: terrorizmin global, krizën e refugjatëve nga Siria si dhe kërcënimi i tretë e që është kualifikuar papunësia në vend. Me këtë rast, ministri Demolli tha se institucionet e shtetit kanë qenë dhe janë të angazhuara në luftën kundër terrorizmit dhe pikërisht falë angazhimit të Qeverisë së vendit janë arritur rezultate të mira në këtë drejtim, duke përmendur statistika si dhe të dhëna konkrete që janë marrë në drejtim të parandalimit të pjesëmarrjes së të rinjve nga Kosova në luftërat e huaja si dhe dënimin e atyre që organizojnë apo edhe marrin pjesë aktivisht.

Ministri Demolli në vazhdim u fokusua tek bashkëpunimi ndërkombëtar i MFSK-së me shumë vende anëtare të NATO-s, shtetet evropiane si dhe vende të rajonit. Ai tha se: „Ne kemi marrëveshje zyrtare bashkëpunimi me shumë vende mike dhe të gjithë i çmojmë për bashkëpunimin e shkëlqyer por partner i yni strategjik mbeten Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA) përkatësisht Garda Kombëtare e Ajovës". Ministri i FSK-së, Haki Demolli me këtë rast përmendi aktivitetet e bashkëpunimit me Ajovën, duke theksuar se për 12 muaj kemi pasur rreth 50 aktivitete dhe shkëmbime të përbashkëta, ku përfitues kryesor ka qenë Ministria për FSK dhe FSK-ja. Në takim me Komitetin e Senatit amerikan, ministri Demolli e njoftoi delegacionin mbi misionin detyrat dhe zhvillimin e FSK-së, ndërsa më tej e vuri theksin tek përgatitjet dhe planifikimet për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Ministri Demolli tha se jemi përkushtuar për procesin, transparent, të transformimit dhe se kemi marrë të gjithë hapat e nevojshëm ligjor dhe procedural dhe se aktualisht jemi në fazën e pritjes së vendimit politik që do të merret nga institucionet më të larta të vendit.



Në fund të fjalës së tij, ministri Demolli tha se Kosova ka qëllim të transformojë Forcën e Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, Forcë e cila do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit si dhe forcë multietnike si dhe forcë e cila nuk do të paraqet kërcënim për asnjë vend, e ndërtuar me standarde të NATO-s, duke përsëritu qëllimin e Republikës së Kosovës për integrim në Bashkimin evropian dhe anëtarësimin në NATO dhe iniciativa tjera rajonale dhe më gjerë. Nga ana e tij, kryesuesi i delegacionit të Komitetit të Senatit Amerikan për Shërbime të Armatosura, Tom Goffus tha se Shtetet e bashkuara të Amerikës janë të interesuar për sigurinë, stabilitetin e Kosovës dhe për stabilitetin e rajonit të Ballkanit, duke ditur që stabiliteti i Kosovës varet edhe nga stabiliteti në rajon. Sa i përket çështjes së transformimit të FSK-së në FAK, Tom Goffus tha se: „Sa më transparent të jeni aq më të besueshëm do të jeni". Më tej zotëri Goffus u interesua mbi disa çështje operacionale si nivelin e ndërveprueshmërisë me institucionet tjera të sigurisë në Kosovë. Në fund të fjalës së tij, kryesuesi i Komitetit të Senatit Amerikan për Shërbime të Armatosura, Tom Goffus ri konfirmoi se siguria dhe paqja në Kosovë janë të rëndësishme për Shtetet e Bashkuara.

Bashkëpunimi i mirë i FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës Haki Demolli i shoqëruar nga zëvendësministrat e FSK-së, Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 2 korrik, priti në MFSK, senatoren e shtetit të Ajovës Joni Ernst, e cila shoqërohej nga ambasadori i SHBA-ve në Kosovë Greg Delawie, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralmajor Timothy Orr si dhe ushtarakë dhe zyrtarë të tjerë të lartë nga SHBA-të. Në takim ministri Demolli, mysafirët e lartë nga SHBA-ja i njoftoi për situatën e përgjithshme të sigurisë, për ta vlerësuar atë si të kënaqshme, duke pasur parasysh



zonën gjeografike ku gjendet Kosova. Me këtë rast, ministri Demolli falënderoi SHBA-të për ndihmën e vazhdueshme që po jep për FSK-në, si me; donacione, këshillime profesionale, shkollime, trajnime dhe ushtrime të përbashkëta. Me këtë rast, Ai vlerësoi lartë edhe bashkëpunimin intensiv dhe të frytshëm me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ministri Demolli, me theks të veçantë, gjatë takimit me senatoren, foli lidhur me procesin e përgatitjes së transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura.

Nga ana e saj, senatorja Joni Ernst shprehu kënaqësinë për arritjet e deritashme të FSK-së dhe shkallën e lartë të bashkëpunimit në mes të FSK-së dhe ushtrisë së SHBA-ve, përkatësisht me Gardën Kombëtare të Ajovës, duke shprehur bindjen dhe urimin që ky bashkëpunim të thellohet edhe më tej në të ardhmen. Pas takimit me ministrin Demolli, senatorja Joni Ernst pati një takim me femrat ushtarake të FSK-së, ku ajo foli për të kaluarën e vet ushtarake dhe sfidat që has gjinia femërore në ushtri. Ndërkaq, nga të pranishmet, senatores Ernst ju bënë pyetje me interes të veçantë për rrolin e femrës në shërbimin ushtarak. Të pranishëm gjatë takimi me senatoren Joni Ernst, ishin edhe gjeneral brigade Xhavit Gashi-atasheu ushtarak i FSK-së në SHBA, Latif Leku - shef i Kabinetit të Ministrit dhe kolonel Ilir Qeriqi-shef i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK.

Gjenerali Gëzim Hazrolli priti zëvendëskomandantin e KFOR-it, gjeneralin Fierenc Korom

Sot, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli më 15 korrik priti në një takim zyrtar zëvendëskomandantin e KFOR-it, gjeneralin Fierenc Korom. Gjatë takimit gjeneral Hazrolli e njoftoi homologun e tij, gjeneralin Korom, me zhvillimet dhe të arriturat e përgjithshme të FSK-së, siç janë trajnimet, ushtrimet dhe bashkëpunimi i saj me KFOR-in. Më pas të dy zëvendëskomandantët biseduan edhe lidhur me ushtrimin fushor „Silver Sabre". Po ashtu, me theks të veçantë, ata u ndalën tek thellimi i bashkëpunimi në mes të FSK-së dhe KFOR-it, i cili bashkëpunim është vlerësuar nga ana e tyre në interes të projekteve të reja të përbashkëta, si dhe në interes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Gjithashtu gjeneral Hazrolli e njoftoi gjeneralin Korom me përgatitjet që po bëhen rreth organizimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 5",ku do të merr pjesë edhe KFOR-i.

Ministri Haki Demolli priti ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Gernot Pfandlerin

Më 19 korrik 2016, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli priti në një takim zyrtar ambasadorin e Austrisë në Kosovë, z. Gernot Pfandler. Ministri Demolli fillimisht falënderoi ambasadorin e Austrisë për ndihmën e vazhdueshme që Qeveria e Austrisë ka dhënë dhe po vazhdon të jep për Kosovën e në veçanti për FSK-në. Me pas ministri Demolli e njoftoi ambasadorin e Austrisë, z. Pfandler me të arriturat e përgjithshme të FSK-së; zhvillimet aktuale, procesin e transformimit të FSK-së, bashkëpunimin



rajonal dhe me partnerë tjerë ndërkombëtarë. Gjithashtu, ministri Demolli dhe ambasadori Pfandler biseduan edhe për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mundësin e intensifikimit të këtij bashkëpunimi edhe në fusha tjera në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Austrisë. Ndërsa, ambasadori i Austrisë në Kosovë, z. Pfandler shprehu kënaqësinë e tij, për pritjen në Ministrinë e FSK-së, si dhe premtoi vazhdimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në fusha me interes të përbashkët për të dy ministritë. Në takim morën pjesë edhe shefi i kabinetit të ministrit Demolli, z. Latif Leka dhe Berta Hamza, asistente e ambasadorit të Austrisë.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjenerali Enver Cikaqi përfundoi studimin njëvjeçar në "Kolegjin Mbretëror të Mbrojtjes" në Londër



Më 28 korrik, në Kolegjin Mbretëror për Studime të Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar në Londër, pas përfundimit të studimeve një vjeçare, diplomoi me sukses gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së. Kolegji Mbretëror për Studime të Mbrojtjes është niveli më i lartë i edukimit për ushtarak dhe diplomat në Angli, është një koncept i studimit, post-diplomik, ku marrin pjesë të gjitha institucionet e sigurisë, që janë të përfshira në ndërtimin e strategjive të sigurisë dhe të mbrojtjes në Mbretërinë e Bashkuar. Ky Kolegj përgatitë liderë strategjik përmes programit të avancuar për zhvillim të lidershipit dhe të menduarit strategjik. Studimet gjatë këtij viti akademik i kanë ndjekur 96 studentë nga 53 shtete të ndryshme të Botës, kurse nga Kosova këtë vit ishte gjeneral brigade Enver Cikaqi. Në ceremoninë e diplomimit ishte prezent edhe e ngarkuara me punë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër, znj. Elmaze Pireva dhe atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, kolonel Richard Perry. Pas diplomimit, gjeneral Cikaqi falënderoi Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ai shtoi se studimi në këtë kolegj, ishte një përvojë e jashtëzakonshme dhe sfiduese. "Unë, kam qenë njeriu më me fat, që pata rastin ta kryejë këtë kolegj me renome botërore. Jam angazhuar që ta prezantojë vetveten dhe shtetin tim, në mënyrën më të mirë të mundshme". Pjesëmarrës në studime ishin përfaqësues të shteteve që kanë bashkëpunim me Mbretërinë e Bashkuar, si shtetet e Commonwelth-it, shtetet nga Amerika e Jugut, Afrika, Azia e Largët, Lindja e Mesme, Shtetet Arabe, Evropa, Kosova, Shqipëria etj.

"Gjatë studimit kemi pasur bashkëpunim me përfaqësues të shteteve pjesëmarrëse, por edhe gjatë vizitave me karakter studimi të institucioneve të sigurisë në shumë shtete të ndryshme të botës. Kuadri i ligjëruesve ishte i jashtëzakonshëm me një përgatitje të lartë dhe karrierë të gjatë në aspektin diplomatik e të sigurisë, kurse gjatë vizitave kemi takuar liderë e diplomat të nivelit botërorë, të cilët janë pjesë e institucioneve vendimmarrëse në organizatat e ndryshme të sigurisë në Botë. Në Mbretërinë e Bashkuar kemi realizuar vizita në institucione shtetërore, ku jemi njoftuar me organizimin e këtyre institucioneve dhe funksionimin e tyre". Gjeneral Cikaqi u shpreh se këtë përvojë, në të ardhmen, do ta realizojë në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe institucionet e sigurisë të shtetit të Kosovës.


Në Ministrinë e FSK-së u mbajt Forumi i parë i nënoficerëve të lartë

Në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK) më 27 korrik, zhvilloi punimet ,,Forumi i parë i nënoficerëve të lartë" nën organizimin e MFSK-së dhe me pjesëmarrje të nënoficerëve të lartë të FSK-së dhe atyre ndërkombëtarë nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, Qendra trajnuese e ushtrisë së 7-të, KFOR-it, Ambasadës amerikane në Prishtinë etj. Punimet e Forumit i shpalli të hapura rreshter majori i Forcës së Sigurisë, Genc Metaj i cili njëkohësisht ishte edhe kryesues i forumit. Në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, një fjalë rasti e mbajti drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi, i cili i falënderoi nënoficerët nga Komanda e Ushtrisë amerikane për Evropë, nënoficerët e KFOR-it, Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në(NLAT), pastaj ata të Ekipit Këshillues të NATO-s për Ministrinë e FSK-së(NAT), si dhe të gjithë trupën e nënoficerëve të FSK-së, për gatishmërinë për pjesëmarrje dhe kontributin e tyre gjatë zhvillimit të punimeve të forumit. Gjeneral Halimi, më tej, tha se: ,,synimi i KOMFSK-së është që përmes këtij Forumi të shkëmbehen përvojat në mes jush me qëllim të arritjes së standardeve më të larta të kërkuara. Gjithashtu, gjeneral Halimi vuri theksin tek synimi i komandantit të FSK-së, për krijimin e ,,Korit të nënoficerëve' "të avancuar, i cili siç u shpreh ai ka për qëllim ngritjen e nivelit të punës dhe profesionalizimit në FSK, e posaçërisht në këtë kohë të përgatitjeve për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura(FAK). Në fund të fjalës së tij, gjeneral brigade Zymer Halimi tha se; "ne jemi të bindur se gjatë diskutimeve ju do t'i analizoni të gjitha punët e mira që janë realizuar bashkërisht, edhe ato që kanë mundur edhe më mirë të realizohen gjatë aktiviteteve të përbashkëta që kemi pasur dhe që pasojnë si: ,,Reagimi i menjëhershëm", ,,Përpjekja e përbashkët", Ushtrimi i përbashkët me KFOR-in (Shpata e argjendtë), si dhe shumë aktivitete tjera me aktorë të ndryshëm siç është përgatitja për ushtrimin fushor të FSK-së ,,Shqiponja 5"."Rreshter majori i Komandës së Ushtrisë amerikane për Evropë, Sheryl Lyon u shpreh se ndjehet e lumtur që kthehet serish në Kosovë, dhe atë për punë dhe aktivitet me FSK-në. Rreshter major Lyon, gjithashtu tha se në këtë Forum sjell përshëndetjet e komandantit të Komandës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës(SHBA) për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges. Rreshterja amerikane shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetje për FSK-në, në drejtim të zhvillimit dhe profesionalizimit të nënoficerëve në përgjegjësitë dhe detyrat që ata bartin, si dhe në drejtim të zhvillimit të gjithmbarshëm të institucionit dhe rritjes së ndërveprueshmërisë me partnerët. Nga ana e tij kryesuesi i Forumit, rreshter majori i FSK-së, Genc Metaj foli lidhur me hartimin e koncept- dokumenteve dhe rregulloreve, ndër të cilat përmendi Rregulloren për menaxhimin e karrierës dhe Rregulloren për konceptin zhvillimor të nënoficerëve. Më pas, rreshter major Metaj foli edhe për planin e përbashkët të bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Ajovës në kuadër të partneritetit shtetëror Kosovë-Ajovë. Ai po ashtu tha se është duke u punuar që të kompletohet struktura e kanalit të nënoficerëve, si dhe shkurtimisht foli mbi Kursin e reagimit të lidershipit. Në punimet e Forumit ishin të pranishëm edhe rreshter majori i Brigadës për Reagim të Shpejtë, Shefqet Hasani, i cili gjatë fjalës së tij foli rreth përgatitjeve që janë duke u zhvilluar për mbarëvajtjen e ushtrimit fushor të FSK-së ,,Shqiponja 5". Ndërkaq, rreshter majori Xhevdet Mataj foli për rishikimin e kurrikulave të kurseve specialistike, rreshter major Jeffrey Sweezer për pikëpamjet e Akademisë së Nënoficerëve të Ushtrisë së shtatë, rreshter major i Komandës së KFOR-it, Amedeo Russo foli mbi bashkëpunimin e KFOR-it me FSK-në dhe përshtypjet për ushtrimin e përbashkët ,,Shpata e argjendtë", rreshter major i Komandës së Grupit Shumëkombësh Lindje(bondstill), Timothy Hileman, informimi për kursin e lartë për lider, rreshter major i Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, Mathew Sides, rreshter majori i NLAT-it, Dusan Ivancic, etj.

Gjatë punimeve të Forumit të parë të nënoficerëve, u debatua për trajnimin, ngritjen e nivelit të bashkëpunimit, harmonizimin si dhe për një varg çështjesh të cilat kanë të bëjnë me avancimin e rolit dhe kontributit të nënoficerëve në çdo ushtri, e në veçanti të nënoficerëve të FSK-së, në këtë fazë.

Gjenerali Gëzim Hazrolli, vizitë në Forcat e Armatosura të Gjermanisë

Me ftesë të Forcave të Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë, një delegacion i Forcës së Sigurisë të Kosovës të prirë nga gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendës- komandant i Komandës se Forcës Tokësore, nga data 27.06.2016 deri me 01.07.2016 qëndroi për një vizitë zyrtare-pune në Gjermani. Delegacioni i FSK-së, shoqërohej nga drejtori i NLAT-it (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, në FSK) gjeneral brigade Ernest Horn si dhe stafi i tij. Qëllimi i kësaj vizite ishte vazhdimi dhe thellimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimet në mes Forcave të Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës si dhe shkëmbimi i përvojave në fushën e personelit, operacioneve dhe logjistikes. Fillimisht, delegacioni i FSK-së, ka bërë një vizitë në Brigadën e 41-të të Mekanizuar në Neubradenburg, ku është takuar me stafin e Komandës. Gjatë këtij takimi shefi i Shtabit të kësaj brigade ka paraqitur një rezyme për organizimin e brendshëm; punët dhe detyrat të cilat zhvillohen, të arriturat e përgjithshme, trajnimet, shkollimet dhe angazhimet në misione jashtë vendit. Më pas, delegacioni i FSK-së, ka vizituar Batalionin 142-të të Logjistikes në Hagenow, Batalionin 803-të të Xhenios në Havelberg si dhe Qendrën e Rekrutimit të Ushtrisë Gjermane në Berlin. Për nder të delegacionit të FSK-së, pala gjermane ka demonstruar disa operacione në fusha të minuara, në lëmin e mirëmbajtjes dhe transportit, ndërtimit të urave për kalim të personelit dhe automjeteve të rënda mbi lumenj etj.



Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe delegacioni që ai udhëhiqte, pas demonstrimit të shkathtësive të ushtarëve gjerman i përgëzoi ata për profesionalizmin e treguar dhe mundësinë që ia dhanë delegacionit të FSK-së, për të përcjellë shkathtësitë e tyre si dhe teknikën ushtarake. Gjithashtu gjatë takimeve janë shkëmbyer përvojat nga të dy palët në fusha të ndryshme. Në fund, delegacioni i FSK-së, bashkë me gjeneralin Ernest Horn, kanë vizituar edhe Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin, ku janë pritur nga zëvendës ambasadori Zemaj, atasheu i FSK-së, kolonel Xhavit Sadrijaj dhe stafi tjetër i ambasadës.

Kadetët e FSK-së përfunduan me sukses operacionet në 'Kampin veror 2016' në Krivollak të Maqedonisë

Në poligonin stërvitor ushtarak në Krivollak të Republikës së Maqedonisë, më 13.07.2016, kadetët e shteteve pjesëmarrëse përfunduan me sukses operacionet në kuadër të ushtrimit dymbëdhjetë (12) ditor ,,Kampi Veror 2016", ku krahas kadetëve të 13 shteteve si nga: SHBA, Britania e Madhe, Turqia, Sllovenia, Rumania, Italia, Shqipëria, Maqedonia dhe vendet tjera, morën pjesë edhe kadetët e FSK-së, të cilët demonstruan me sukses aftësitë e tyre profesionale, për atë, çka ushtruan gjatë këtyre ditëve të qëndrimit në këtë kamp.

Ushtrimi fushor "Kampi Veror 2016" u organizua nga Ministria e Mbrojtjes dhe Akademia Ushtarake e Maqedonisë, dhe ka karakter ndërkombëtar, ku për çdo vit po marrin pjesë kadetët e vendeve të ndryshme të rajonit, të menaxhuar nga instruktorë të NATO-s dhe të Partneritetit për Paqe (PpP). Për të përcjellë ushtrimin fushor kishin ardhur edhe shumë oficerë të lartë nga ushtritë e shteteve pjesëmarrëse. Nga FSK-ja ishin të pranishëm gjeneral brigade Zymer Halimi- drejtor i Drejtorisë për Operacione, kolonel Irfete Spahiu- zëvendëskomandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), Ibrahim Shala- drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, major Avni Kiçina- komandant i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, (QSU) si dhe këshilltar të Ekipit Këshillues të NATO-s për MFSK-në dhe FSK-në. Në ditën e fundit të ushtrimit





fushor, kadetë e të gjitha vendeve pjesëmarrëse, gjatë demonstrimit përbënë një batalion shumëkombësh të ngarkuar me detyra të operimit dhe realizimit në terren. Ushtarët dhe eprorët pjesëmarrës treguan një nivel të lartë të angazhimit, veprimit dhe koordinimit në mes tyre, duke vepruar si njësi unike në realizimin e detyrave të përcaktuara sipas skenarit të ushtrimit. Me këtë rast, zëvendësministri i Mbrojtjes i Maqedonisë, z. Bekim Maksuti tha se sivjet është shënuar numër rekord i pjesëmarrësve në këtë kamp, ndërsa pjesëmarrësit e këtyre shteteve mund të tregojnë se mund të flasin dhe mund të bashkëpunojnë me një gjuhë të përbashkët. "Është hera e parë që sivjet ka kaq numër masiv pjesëmarrësish, prej 13 vendeve me një numër rekord prej 290 pjesëmarrës, organizuar në një afat 10 ditorë. Të gjitha shtetet pjesëmarrëse duke filluar nga SHBA, Britania e Madhe, Sllovenia, Turqia, Rumania, Italia, Kosova, Shqipëria si dhe nga përfaqësues të studentëve të universiteteve, të cilët në bazë të plan- programeve të tyre përputhen me korrikulën e këtij kampi veror, ishin sot, dhe na treguan neve se si liderët e ardhshëm të vendeve të tyre por edhe studentët mund të flasin një gjuhë të përbashkët. Pra mund të flasin nga 13 vende, mund të bashkëpunojnë për një të ardhme më të mirë të vendeve të tyre dhe për me për një bashkëpunim dypalësh ndërmjet vendeve dhe ministrive të Mbrojtjes", -tha në fund zëvendësministri Maksuti. Ndërsa, drejtori i Drejtorisë për Operacione dhe Trajnime në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi, pos tjerash tha:" Kampi veror" që nga viti 2010 është bërë tradicional dhe është shumë i rëndësishëm, pasi që kadetëve të FSK-së iu është dhënë mundësia që të këmbejnë eksperienca mes kadetëve pjesëmarrës të 13 shteteve tjera. "Këtë aktivitet e organizojmë dhe e realizojmë qe disa vjet me radhë dhe tani është bërë një aktivitet tradicional. Që nga viti 2010 i kemi kadetët tanë në këtë kamp në poligonin e Krivollakut. Ky është një aktivitet jashtëzakonisht i rëndësishëm, për arsye se kadetët nga 13 shtete pjesëmarrëse në këtë kamp kanë mundësi të shkëmbejnë eksperienca, të familjarizohen, të bashkëbisedojnë dhe të shohin aktivitetet e njëri- tjetrit, të bëjnë krahasime se si mund të organizohen edhe më mirë",-tha në fund gjeneral Halimi.

Kadetët e FSK-së, pjesëmarrës në "Kampin veror 2016", edhe këtë vit u dalluan me paraqitjen e tyre të shkëlqyeshme si në operacionet individuale ashtu edhe kolektive.



Diplomojnë kadetët e rinj të FSK-së, gjenerata 2016



Në kazermën e FSK-së ?Skënderbeu? në Ferizaj, më 1 korrik u zhvillua ceremonia solemne e diplomimit të kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, gjenerata 2016.

Në ceremoni morën pjesë: ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral major Timothy Orr, zëvendësministrat e FSK-së, Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, gjeneral brigade Bashkim Jashari, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, kolonel Irfete Spahiu, kolonel Naim Haziri dhe ushtarakë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së, atashetë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Muharrem Sfarqa, familjarë të kadetëve si dhe të ftuar tjerë. Pas ngritjes së Flamurit dhe intonimit të himnit, ministri i Ministrisë së FSK-së, z. Haki Demolli, tha se diplomimi dhe gradimi i kadetëve të FSK-së për mua si ministër i FSK-së është një ngjarje e veçantë që më bënë të ndihem krenar. Ministri Demolli diplomimin dhe gradimin e 9 kadetëve të FSK-së të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, në gradën e nëntogerit, e cilësoi si një ditë të veçantë për FSK-në. Kjo është dita e kurorëzimit të një pune të gjatë, është dita e ëndërruar që juve ju ka shty para 4 viteve të vendosni që të vishni uniformën dhe të bëheni pjesëtarë të FSK-së, të bëheni oficerë të karrierës. ,,Realizimi i kësaj ëndrre rinore, sigurisht se ka kërkuar punë këmbëngulëse dhe studime të kombinuara në qendrën ushtarake dhe në universitetet civile. Kjo ditë shënon kalimin në një fazë të re zhvillimi, kur juve ju hapet mundësia për t'u aktivizuar në FSK si oficerë aktiv, për të filluar karrierën e oficerit". Për suksesin e kadetëve, me këtë rast, ministri Demolli përgëzoi stafin akademik trajnues të KDS-së dhe të QSU-së, për punën e tyre të palodhshme në përgatitjen dhe stërvitjen e kësaj gjenerate.

FSK-ja është një shembull i zhvillimit dhe i progresit përmes investimit në dije dhe në shkencë. ,,Kjo po dëshmon më së miri, se ne po e krijojmë një forcë profesionale dhe me standardet më të larta ushtarake, me standarde të NATO-s". Ministri Demolli, më pastaj i porositi kadetët e sapo diplomuar: "Oficerë të rinj, ju sot me të drejtë jeni të mbushur me krenari dhe gëzim, duke na siguruar për një të ardhme me perspektivë të sigurt. Si ministër i MFSK-së ju porosis që të mos harroni se: nuk ka mision më të shenjtë se të jesh oficer në shërbim të mbrojtjes së lirisë dhe demokracisë; vlera dhe parime këto për të cilat gjenerata të tëra kanë sakrifikuar shumë duke dhënë jetën e tyre në altarin e lirisë". Ndërkaq, për shkollimin e kadetëve në QSU ministri u shpreh: "Doktrina e stërvitjes dhe shkollimi i kadetëve të FSK-së, është bazua plotësisht mbi dijet dhe shkencën ushtarake dhe standardet e ushtrive më të avancuara, e kombinuar me shkollimin paralelë në institucione civile, por edhe një mundësi e së ardhmes për specializime të ngushta në perspektivën e karrierës ushtarake.

Në fund, ministri Demolli i përgëzoi kadetët. Diplomimi i juaj është më ndryshe nga gjeneratat tjera, sepse ju diplomuat në vitin kur Kosova, Ministria dhe FSK-ja,





kemi bërë të gjitha përgatitjet, që janë kërkuar nga procesi për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK). Ne si ministri e FSK-së dhe Qeveria e Kosovës jemi duke punuar shumë, që ky objektiv madhor i fushës së mbrojtjes dhe sigurisë së vendit të realizohet sa më parë. Shikuar nga perspektiva e kadetëve të sapo diplomuar, kuptohet se FAK-u do të ketë një strukturë të re, mision të ri dhe mundësi të reja, për ju si oficerë të rinj në moshë, me punën tuaj nëpër njësi të ndryshme, mund të jepni tërë dijen dhe përvojën tuaj, përkushtimin tuaj, në ngritjen dhe konsolidimin e Ushtrisë së Kosovës. Kadetë të nderuar, Urime dhe suksese në karrierën tuaj ushtarake. Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij me rastin e diplomimit të kadetëve tha se ndihet shumë krenar në këtë ditë të veçantë për FSK-në. ,,Sot jemi këtu që të shprehim mirënjohjen tonë për guximin dhe vetëmohimin që kanë treguar kadetët gjatë këtyre katër viteve. Ju kaluat sfida të mëdha fizike dhe mentale, me të vetmin qëllim që të edukoheni dhe të përgatiteni për t'i shërbyer vendit dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Por më duhet të ju them që ky është vetëm fillimi i rrugëtimit tuaj në këtë profesion fisnik. Gjatë karrierës tuaj ju do të ballafaqoheni me beteja të ndryshme, të cilat ju si udhëheqës, duhet t'i zgjidhni. Unë kam besim të plotë që me edukimin dhe trajnimin që keni bërë, vlerat që mësuat, dhe gatishmërinë tuaj, do të ia dilni shkëlqyeshëm të jeni në shërbim të vendit dhe në ndihmë të qytetarëve atëherë kur ata kanë nevojë më së shumti. Nga ju pres që të jeni udhëheqës të ndershëm, të guximshëm dhe të punoni me përkushtim. Gjithashtu, pres nga ju, që të gjitha vështirësitë me të cilat do të ballafaqoheni në të ardhmen, t'i ktheni në mundësi, se vetëm kështu ne do të zhvillojmë dhe avancojmë institucionin tonë që të jetë i gatshëm të përmbush misionin e vet, t'u dalë në ndihmë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të kontribuojë në sigurinë regjionale e globale". Gjeneral Rama me këtë rast, përgëzoi stafin e KDS-së, për punën e palodhshme që është duke e bërë në zhvillimin profesional të gjithë pjesëtarëve të FSK-së, e në veçanti stafin e Qendrës për Studime Universitare, të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm po punojnë për edukimin dhe trajnimin e oficerëve të rinj. Po ashtu gjeneral Rama një falënderim të veçantë e pati edhe partnerët tanë, të cilët siç tha ai "vazhdimisht po na përkrahin në procesin e rëndësishëm të edukimit, shkollimit, stërvitjes dhe ngritjes së kapaciteteve tona. Pa përkrahjen tuaj, FS-ja nuk do të ishte këtu ku është sot".

Gjenerali Amerikan Timothy Orri: Ju sot e keni bërë krenare tërë Kosovën



Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës (SHBA) gjenerali Timothy Orr u shpreh i emocionuar me arritjet e kadetëve të FSK-së, për këto katër vjet gjatë shkollimit. "Në ju, unë shohë drejtues me integritet dhe shërbyes shembullor. Ju keni punuar shumë përgjatë katër vjetëve, që të arrini sot, këtu dhe të merrni gradën e nëntogerit. Ju sot e keni bërë krenare tërë Kosovën. Ju jeni më të mirët e të mirëve që ka Kosova. Para së gjithash mbani mend, vendi juaj ka investuar kohë, para dhe udhëheqje që ju të arrini këtë pikë të karrierës ushtarake" tha në fund gjenerali amerikan Orr. Pas leximit të urdhrit për gradimin e kadetëve në gradën e nëntogerit, ministri Demolli, gjeneral Rama, gjenerali Orr, kolonel Spahiu dhe majori Kiqina u dhanë certifikatat, oficerëve të rijnë të FSK-së. Më pas, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama i dorëzoi kadetit-Eugen Thaçit, çmimin "Kadeti më i mirë i gjeneratës 2016". Kadetët e sapo diplomuar: Behar Fazliu, Eugen Thaçi, Rilind Idrizi, Xhemal Mziu, Kemajl Haliti, Drilon Hasani, Zymer Kukalaj, Çlirim Morina dhe Besfort Kurteshi dhanë betimin solemn para komandantit të QSU-së, major Avni Kiqina.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, priti në takime lamtumirës këshilltarët e NAT-it



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli gjatë muajit korrik ka pritë në takime (të ndara) lamtumirës këshilltarë të NAT-it (Ekipi Këshillues i NATO-s për MFSK-në), të cilët kanë kryer mandatin e punës zyrtare një vjeçare. Ministri Demolli në emër të Ministrisë së Forcës ka falënderuar këshilltarit, zëvendës drejtorin e NAT-it, kolonelin italian Materrase, atasheun ushtarak të Shqipërisë kolonel Hoxhën, për kontributin, përkushtimin dhe angazhimin e tyre profesional gjatë kohës së shërbimit të tyre në MFSK dhe në Kosovë. Ministri Demolli me këtë rast është shprehur: " U jam shumë mirënjohës për kontributin tuaj personal dhe profesional që keni dhënë në krijimin dhe zhvillimin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Shpreh falënderimet e mia të sinqerta për ju, për atë që keni bërë gjatë kohës si Ekipit Këshillues të NATO-s. U jam shumë mirënjohës, që për dymbëdhjetë muaj keni shërbyer në MFSK, në këtë kohë shumë të rëndësishme, si dhe për kontributin tuaj personal dhe mbështetjen për zhvillimin e vazhdueshëm të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë takimit, ministri Demolli në shenjë respekti për punën, angazhimin dhe kontributin e tij, gjatë shërbimit në Kosovë u dha ,,Certifikatë-Mirënjohje".

Me këtë rast, ministri Demolli nderoi me Mirënjohje, zëvendës drejtorin e NAT-it, kolonelin Jacobus nga SHBA-të, këshilltaren nga Letonia znj. Sanita Zhogota, këshilltarin Radovan Srsa nga Sllovenia, kolonelin italian Francesco Matearresse dhe atasheun ushtarak nga Shqipëria kolonel Fiqri Hoxhën. Ndërsa nga ana e tyre të gjithë janë shprehur tejet të lumtur që patën rastin, që për dymbëdhjetë muaj të punojë në Kosovë, gjegjësisht në FSK. Ata falënderuan ministrinë Demolli, komandantin e FSK-së gjeneralleitënant Rrahman Rama si dhe stafin udhëheqës të FSK-së, për bashkëpunim, duke u uruar suksese të mëtejme në realizimin e detyrave të përgjithshme.

Oficerë të lartë të FSK-së diplomojnë në Akademinë e Mbrojtjes të Shqipërisë





Në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, më 22 korrik 2016, u zhvillua ceremonia e diplomimit të oficerëve të lartë me gradën nënkolonel dhe major të cilët përfunduan studimet akademike gjatë vitit 2015-2016, Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) dhe Kursin e Komandës së Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP). Në të dyja kurset, diplomuan 24 ushtarakë nga Shqipëria dhe 4 oficerë të lartë të FSK-së, nga Kosova. Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) zhvillohet çdo vit në Akademinë e FA, dhe përgatit oficerë të përzgjedhur të karrierës me gradën e nënkolonelit, për të shërbyer në detyra e funksione të larta në FA, shtabet e NATO-s, ku Shqipëria është e përfaqësuar, si dhe në institucionet e tjera të sigurisë. Kurrikula e Kursit të Lartë të Oficerit përfshin fushën e strategjisë dhe historisë, të lidershipit dhe shkencave shoqërore, si dhe atë të operacioneve. Kurse Kursi i Komandës së Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) përgatitë oficerë të përzgjedhur të karrierës në pozicionet kyçe të komandimdrejtimit të reparteve e njësive, shtabeve të të gjitha niveleve, si dhe ato shumëkombëshe të NATO. Kursin e Lartë të Oficerit nga FSK-ja e kryen nënkolonelët: Hamdi Pallomi e Ilir Shyti kurse Kursin e Komandës së Shtabit të Përgjithshëm majorët: Enver Hoti e Valdet Berisha. Për të përcjellë ceremoninë e diplomimit-certifikimit nga Kosova morën pjesë, ambasadori i Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë Ramiz Ladrovci, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtor i Departamentit të Operacioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe nënkoloneli Rifat Sylejmani. Të pranishëm në ceremoni ishin edhe: Zëvendës ministri i Mbrojtjes i RSH-së, Petro Koçi, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA, kolonel Ardian Bali, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Dedë Prenga, komandanti i AFA kolonel Ruzhdi Kuçi gjeneral major Qemal Shkurti, komandantët e Forcave të FA, drejtor drejtorie në Ministrinë e Mbrojtjes e Shtabin e Përgjithshëm, përfaqësuesit amerikanë pranë Qendrës së Simulimit, komandantë të institucioneve, familjarë të akademistëve, si dhe të ftuar të tjerë. Me këtë rast, komandanti i Akademisë së FA-së, kolonel Ruzhdi Kuçi vlerësoi lartë angazhimin e oficerëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës të cilët treguan nivel të lartë profesionalizmi "duke pasuruar në këtë mënyrë jetën akademike e ushtarake të institucioneve shqiptare". Ai, pos tjerash tha se: "Programet që implementuam në KLO dhe KKSH janë rezultat i rishikimit dhe diskutimit të gjerë akademik të eksperiencës së mëparshme si dhe studimit të programeve të disa akademive të vendeve anëtare të NATO-s". Ndërsa zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, tha se: "ky kurs ka qenë shumë i rëndësishëm, sidomos për aftësimin e oficerit drejtues, për të planëzuar taktikisht dhe atë në nivelin operativ, apo në kushtet e operacioneve komplekse". Kurse ambasadori i Kosovës në Shqipëri, Ramiz LLadrovci dhe gjeneral brigade Nazmi Brahimaj kanë falënderuar Republikën e Shqipërisë dhe Akademinë e Mbrojtjes për ndihmën e dhënë në shkollimin e oficerëve të FSK-së. Ata kanë përgëzuar edhe oficerët e lartë të FSK-së, për suksesin e treguar gjatë studimeve brenda një viti kalendarik, këtu në AM të Republikës së Shqipërisë.

FSK-ja në konferencën 'Combined Training Conference' të NATO-s në Gjermani

Një delegacioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) udhëhequr nga kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, toger Mimoza Budeci, oficere ndërlidhëse me ODC të SHBA-ve dhe përfaqësuesi i ODC-së, nga data 25 deri me 29 korrik 2016, po marrin pjesë në konferencën e përbashkët për trajnime 'Combined Training Conference' të organizuar nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, e që po mbahet në shkollën e NATO-s, në Oberammergau të Gjermanisë. Qëllimi i mbajtjes së kësaj konference është koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve trajnuese individuale, grupore dhe ushtrimeve të ndryshme. Gjithashtu delegacioni i FSK-së, ka marr pjesë edhe në disa sesione të veçanta me përfaqësuesit e ushtrisë amerikane, shteteve partnere duke përfshirë edhe shtetet rajonale me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen. FSK-ja ka konfirmuar pjesëmarrjen në disa trajnime individuale, grupore dhe ushtrimeve të ndryshme ndërkombëtare. Gjatë konferencës delegacioni i FSK-së, ka prezantuar edhe ofertën e saj, për ushtrimet e ndryshme që do të mbahen nga Forca e Sigurisë së Kosovës, ku janë ftuar shtetet e ndryshme të marrin pjesë. "Vetë pjesëmarrja në konferencën 'Combined Training Conference' të organizuar nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, këtu në Gjermani, është me rëndësi për FSK-në, në radhë të parë për bashkëpunimin dhe për koordinimin e ushtrimeve dhe trajnimeve të përbashkëta që janë edhe në interes për Forcës së Sigurisë të Kosovës" tha kolonel Ilir Qeriqi, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri i Ministrisë për FSK-në. Konferenca pritet, më 29 korrik 2016, t'i përmbyll punimet.

Koloneli amerikan Gerald Boston, vizitë pune në FSK-së



Komandanti i Organizatës për Menaxhimin e Trajnimit të Asistencës së Sigurisë(Security Assistance Training Management Organization(SATMO), të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës(SHBA), koloneli Gerald Boston dhe rreshter majori i Komandës, Brian Hester më 22 korrik, qëndruan për vizitë zyrtare dy ditore në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Komandanti i SATMO-s, koloneli Boston u prit në takim nga zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT) të FSK-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli. Në takimin e përbashkët u bisedua lidhur me bashkëpunimin ndërmjet FSK-së dhe SATMO-s sidomos lidhur me asistencën në trajnime dhe ushtrime. Koloneli Boston dhe rreshter majori Hester u pritën gjithashtu edhe në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), nga kolonel Skender Hoxha dhe rreshter majori i FSK-së, Genc Metaj. Në takimin e përbashkët u bisedua për bashkëpunimin e mëtutjeshëm në mes të FSK-së dhe SATMO-s, me ç'rast koloneli Hoxha shprehu falënderimet për përkrahjen e vazhdueshme që ekipet e SATMO-s po japin për Forcën e Sigurisë. Delegacioni gjatë vizitës në Komandën e Forcave Tokësore ka përcjell nga afër asistencën që ekipet e Organizatës për Menaxhimin e Trajnimit të Asistencës së Sigurisë janë duke i dhënë FSK-së në përgatitjet për zhvillimin e ushtrimit fushor ,,Shqiponja 5". Më këtë rast, delegacioni i SATMO-s, në krye me kolonelin Boston ka marrë pjesë në prezantimin final të konferencës së mesme planifikuese për ushtrimin fushor të FSK-së ,,Shqiponja 5. Vlen të theksohet se ekipet e SATMO-s vite me radhë janë duke e përkrahur FSK-në në aktivitete të ndryshme, dhe posaçërisht gjatë ushtrimeve fushore. Ky bashkëpunim është mundësuar përmes Zyrës për Bashkëpunim dhe Mbrojtje pranë Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë.

Kolonel Muharrem Rrahmani përfundoi shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) të Forcës së Sigurisë së Kosovës, kolonel Muharrem Rrahmani më 19 korrik u pensionua, duke përfunduar kështu karrierën ushtarake dhe shërbimin shumëvjeçar në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ai u përcoll me nderime nga kolegët e tij, pas një shërbimi të gjatë dhe të përkushtuar. Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, në ceremoninë e organizuar nga FSK-ja me rastin e përfundimit të shërbimit të kolonel Rrahmanit, në emër të Ministrisë dhe në shenjë falënderimi i ndau mirënjohje me motivacion "Për shërbim të suksesshëm, kontribut të palodhshëm dhe angazhim maksimal" gjatë kohës së shërbimit në FSK, si dhe gjatë kohës sa ishte në detyrën e Komandantit të Brigadës për Mbështetje Operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Më tej, ministri Demolli në emër të MFSK-së i uroi pensionimin kolonel Rrahmanit, duke i dëshiruar shëndet të mirë, me ç 'rast ministri u shpreh se:,,MFSK-ja dhe FSK-ja janë



mirënjohëse për punën e palodhshme dhe kontributin që kolonel Muharrem Rrahmani ka dhënë në të gjitha detyrat gjatë shërbimit të tij në FSK, pa harruar, gjithsesi, edhe kontributin e tij për çlirimin e vendit tonë". Gjithashtu, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama në emër të FSK-së i dhuroi medalje "Për shërbim të suksesshëm", duke u shprehur mirënjohës për kontributin e frytshëm që kolonel Muharrem Rrahmani ka dhënë që nga periudha me e vështirë e Kosovës, pastaj për shërbimin në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës(TMK) si dhe në Forcën e Sigurisë, në detyra të ndryshme, pra siç tha gjeneral Rama, kolonel Rrahmani një jetë të tërë ia kushtoi shërbimit në uniformë. Po ashtu, edhe zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore(KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli në emër të KFT-së e falënderoi kolonel Rrahmanin për shërbimin dhe me këtë rast i dëshiroi shëndet të plotë në të ardhmen.

Në ceremoni ishte i pranishëm edhe shefi i Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në(NLAT), gjeneral brigade Ernest Horn i cili në emër të NLAT e falënderoi kolonel Rrahmanin për shërbimin duke i dorëzuar edhe një dhuratë modeste. Një falënderim të veçantë dhe shëndet më tutje, kolonel Rrahmanit i dëshiruan edhe atasheu ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kolonel Chud Buts dhe këshilltari për logjistikë nga NLAT, nënkolonel Vasileios Chatzivantsidis. Ndërkaq në emër të BMO-së, i dhuruan dhurata shefja e Financave, major Hava Latifi, shefi i Batalionit të Logjistikës, major Zenel Zeka, si dhe flamurin e BMO-së si kujtim nga njësia të cilën e ka udhëhequr, kolonel Rrahmani, në fund të karrierës ushtarake ia dorëzoi rreshter major Besim Berisha.

Kolonel Muharrem Rrahmani u lind më 20 korrik 1961 në Galdime të Lipjanit. Ka mbaruar Akademinë Ushtarake Tokësore në ish- Armatën Popullore të Jugosllavisë(APJ). Shërbeu si Komandant Togu, Kompanie, si dhe Zëvendëskomandant Batalioni në ish-APJ. Gjithashtu, ka një përvojë të gjatë ushtarake, në institucione dhe detyra të ndryshme në Kosovë, si: në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Zëvendëskomandant në Brigadën e Mbështetëse Operacionale, shef i Shtabit në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Komandant i Qendrës Kolektive të Trajnimeve në TMK, Oficer për Planifikim të Trajnimit në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së. Kolonel Muharrem Rrahmani u pensionua sipas Ligjit për pensionim të pjesëtarëve të FSK-së, derisa ishte duke ushtruar detyrën e Komandantit të Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së.

Batalioni i Dytë i BRSH-së realizoi Ushtrimin fushor "Panteri 2"

Kompania 2B e Batalionit të Dytë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH) në Istog, më 15 korrik përfundoi ushtrimi fushor, 48 orësh, i koduar "Panteri 2", i cili e përmbylli trajnimin e brendshëm tremujor të kësaj kompanie. Ushtrimi fushor është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Dytë dhe është ekzekutuar nga Kompania 2B, në bazë të Procedurës së Udhëheqjes së Trupave (PUT) me qëllim të vlerësimit të njohurive dhe shkathtësive të fituara gjatë periudhës tremujore të trajnimit. Ky ushtrim u përcoll nga afër edhe nga komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, drejtori i NLAT-it, gjeneral Ernest Horn (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, për FSK), komandanti i Batalionit të Dytë nënkolonel Mehmet Lladrovci, kryetari i Komunës së Istogut Haki Rugova dhe ekipet vlerësuese të Batalionit të Dytë, Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe BRSH-së, me ç 'rast vlerësuan lart mbarëvajtjen e ushtrimit si dhe gatishmërinë e pjesëtarëve. Në mbështetje të këtij ushtrimi fushor kanë qenë edhe njësitë tjera të FSK-së: Njësia e Reagimit në Kriza(NJNRK), Regjimenti i Mbrojtjes Civile (RMC) si dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS).

Në këtë ushtrim fushor janë përfshirë edhe institucionet civile të Komunës së Istogut si Drejtoria për Emergjenca dhe Shpëtim, Policia e Kosovës, Kryqi i Kuq i Kosovës, Agjencia për Emergjenca Civile, Shtëpia e Shëndetit dhe Zjarrfikësit. Gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e Kompanisë 2B dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht në planifikim dhe operacione ushtarake siç janë: Ushtrimet fushore, Drillet e betejave, Lëvizjet taktike individuale, Procedurat e udhëheqjes së trupave, Okupimi i bazës patrulluese, Hyrje në patrullim, Operacione urbane, Pika e kontrollit, Patrullimi me blinda dhe fusha tjera. Ky ushtrim u realizua në bazë të planit vjetor të trajnimeve dhe aktiviteteve të Batalionit të Dytë, listës së detyrave esenciale për zbatimin e misionit dhe planit vjetor të aktiviteteve në Brigadën e Reagimit të Shpejtë.



Batalioni i Tretë i BRSH-së realizoi ushtrimin fushor "Veprimi i Shpejtë- 08"

Kompania 3C e Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) nga data 06-08.07.2016, në Komunën e Vushtrrisë, më 15 korrik realizoi ushtrimin fushor të koduar ,,Veprimi i Shpejt-08", në të cilën morën pjesë njësitë e NJNRK-së, Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) dhe KFOR-i, i cili i ofroi mbështetje FSK-së, me një helikopter për evakuimin e viktimave. Ky trajnimi ka filluar të realizohet nga 11 prilli i vitit 2016, në kuadër të gjenerimit të forcës dhe ka përfunduar më 08 korrik 2016. Në ushtrim kanë marrë pjesë edhe institucionet tjera nga regjioni i Vushtrrisë, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, Policisë së Kosovës, Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Departamentit Shëndetësor, Kryqi i Kuq, Brigada e Zjarrfikësve, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave.



Ushtrimin nga afër e përcollën zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në (NLAT) gjeneral brigade Ernest Horn, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë kolonel Xhevahir Geci, shefi i Operatives nga policia e Kosovës, major Nystret Mehmeti, komandanti i Batalionit të Tretë major Beton Ratkoceri, kryetari i Komunës së Vushtrrisë Bajram Mulaku, zëvendësministri i Bujqësisë Kurtan Kajtazi dhe oficerë e nënoficerë të lartë të FSK-së, Policisë së Kosovës dhe të KFOR-it. Me këtë rast, u mbajt një takim i shkurtër informues ku të pranishmit u njoftuan për mbarëvajtjen e këtij ushtrimi, për rolin dhe rëndësinë e tij dhe njëherësh u bë demonstrimi i njësive reaguese në terren për menaxhimin e situatave të fatkeqësive të zjarrit, aksidenteve të komunikacionit, dhënies së ndihmës së parë, trajtimit të lënduarve si dhe transportimin e të lënduarve nga vendi i incidentit për në Spitalin rajonal të Mitrovicës, në mbështetje nga forcat e KFOR-it, kërkim-shpëtimit, zonës së kontaminuar si dhe operacione urbane. Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli vlerësoi lartë procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor si dhe koordinimin ndërmjet agjencive civile dhe BAT 3-të të BRSH-së. "Sinqerisht duhet të ndjeheni mirë secili prej jush që ka marr pjesë në ekzekutimin e këtyre operacioneve dhe ushtrimit në përgjithësi. Dua t'ju përgëzoj për punën që e keni bërë, që ky ushtrim të jetë i suksesshëm. Ne perfekt na bënë vetëm stërvitja me objektiva të qarta, me zbatim të misionit e misioni i gjithë këtyre institucioneve së bashku me mysafirët tanë ndërkombëtarë, është që të krijojmë një ambient të sigurt, siguri për të gjithë njerëzit në Republikën e Kosovës" e përfundoi fjalën e tij, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli. Ndërsa kryetari i Komunës së Vushtrrisë Bajram Mulaku përgëzoi Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Batalionin e 3-të për organizimin dhe realizimin e ushtrimit fushor. Ky ushtrim vjen në kuadër të planit vjetor të trajnimeve dhe aktiviteteve të FSK-së, ku qëllimi i ushtrimit është mbajtja e nivelit të gatishmërisë së pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe bashkëpunimi me agjencitë tjera në zonën e përgjegjësisë së FSK-së.



Pjesëtarë të FSK-së me sukses kryejnë Kursin Bazik për Parashutizëm Luftarak në Republikën e Kroacisë

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, një ekip oficerësh dhe ushtarësh të FSK-së, prej 6 vetash, për dy javë (25 qershor-08 korrik 2016) kanë kryer trajnimin Bazik për Parashutizëm Luftarak në Republikën e Kroacisë, gjegjësisht në Akademinë Ushtarake në Zagreb. Në këtë trajnim dy javor kanë marrë pjesë: toger Ilir Beqiri, tetar Labinot Kelmendi, tetar Faton Rukovci, ushtar Franjo Kodraj, ushtar Besarta Pacolli dhe ushtar Ilir Kajtazi. Trajnimi është realizuar në dy faza; ku në fazën e parë është mbajtur pjesa teorike për parashutën kryesore MC1-1C dhe atë rezervë T 10R, ndërsa në fazën e dytë është mbajtur pjesa praktike hedhja me parashute nga helikopteri MI 17. Pjesa praktike hedhja me parashutë është realizuar gjatë ditë dhe gjithashtu edhe gjatë natës, me pajisje personale. Të gjitha hedhjet ishin të suksesshme dhe pa probleme. Ushtari më i dalluar ishte Franjo Kodraj i cili të gjitha tekstet me shkrim arrin ti realizoi me rezultatin 100%, dhe të gjitha kërcimet i ka kryer brenda zonës së gjelbër. Vlen të theksohet se për herë të parë në një trajnim të tillë të pjesëtarëve të FSK-së, ka marrë pjesë edhe ushtarja Besarta Pacolli, e cila me sukses ka kryer si pjesën teorike dhe atë praktike.

Gjatë kryerjes së pjesës praktikë; pjesëtarët e FSK-së i ka vizituar edhe zëvendës komandanti i Komandës se Forcave të Operacioneve Speciale të Kroacisë (KFOS) dhe instruktorë të lartë të kësaj njësie të cilët kanë shprehur fjalë të mira për pjesëtarët e FSK-së. Në përfundim të kryerjes së këtij trajnimi dyjavor, në bazën kryesore të Komandës së Forcave Speciale Kroate në Delnicë është mbajtur ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së. Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë stafi i lartë i saj, ndërsa, në hyrje të objektit të komandës së KFOS-së, është valëvitur edhe flamur i Republikës së Kosovës, krahas atij kroat. Në fund të ceremonisë, zëvendës komandanti Komandës së Forcave Speciale të Kroacisë, majori Mirko Bosnjak dhe gjithë stafi komandues kanë lëvduar pjesëtarët e FSK-së, si dhe janë shprehur mese të gatshëm të vazhdojnë bashkëpunimin dhe trajnimin edhe në kurse të tjera më të avancuar për parashutizëm, si dhe trajnimet tjera të nivelit më të lartë që ofron FOS-i. Ndërsa togeri Ilir Beqiri udhëheqës i ekipit të FSK-së, ka vetëm fjalë falënderuese për Komandën e Forcave Speciale Kroate, të cilët kanë treguar konsideratë dhe kujdesin më të lartë për pjesëtarët kursant. Kurse motivi, morali dhe disiplina e të gjithë pjesëtareve të FSK-së, ka qenë shumë e lartë, dhe falë kësaj, edhe përkundër që për herë të parë kemi marrë pjesë në trajnime të tilla, rezultatet kanë qenë të shkëlqyeshme. Ky sukses i pjesëtarëve të FSK-së, është edhe një dëshmi se FSK-ja, çdo ditë po arrin të realizoj trajnime të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit sipas standardeve më të larta të shteteve anëtare të NATO-s.

Certifikohen instruktorë të FSK-së për fitnes fizik



Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, më 26 korrik 2016, u mbajt ceremonia e certifikimit të 15-të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës, të cilët për dy javë më radhë, nga 11-26 korrik 2016, ndoqën trajnimin intensiv "Kursi për Trajnimin Fizik" i cili trajnim u realizuar nga instruktorë të Shkollës Ushtarake për Fitnes Fizik të Mbretërisë së Bashkuar dhe instruktorë të FSK-së. Qëllimi i këtij trajnimi, i cili u realizua në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Mbretërinë e Bashkuar, ishte që të investohet sa më shumë në aftësimin dhe ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, për instruktorë të fitnesit fizik. Fillimisht, pjesëtarët e FSK-së, para të pranishmëve demonstruan disa nga ushtrimet e mësuara si: Cikël ushtrimesh me pajisje të improvizuara, tipat dhe llojet e ndryshme të vrapimeve, fitnesi fizik ushtarak, poligoni me pengesa etj., të cilat demonstrime nga të pranishmit u vlerësuan lartë për aftësitë fizike dhe mendore të treguara gjatë paraqitjeve. Për të përcjellë këtë ceremoni të pranishëm ishin: Gjeneral brigade Zymer Halimi- drejtor i Drejtorisë për Operacione, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT)- gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i ngarkuari me punë i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë- z. Daniel Fearn, atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar- kolonel Richard Perry, këshilltari i komandantit të FSK-së - kolonel Andy Lyton, zëvendëskomandanti i KDS-së- kolonel Irfete Spahiu, instruktorë të Mbretërisë së Bashkuar dhe të FSK-së, si dhe oficerë të lartë të FSK-së. Me këtë rast, gjeneral brigade Zymer Halimi, në emër të FSK-së falënderoi Mbretërinë e Bashkuar, Ambasadën dhe instruktorët ushtarakë të saj, për ndihmën që ata ofruan për përgatitjen e instruktorëve të Fitnesit Fizik, si dhe i përgëzojë instruktorët dhe pjesëtarët e FSK-së për angazhimin dhe suksesin e treguar gjatë këtij trajnimi. Gjeneral Halimi, duke iu drejtuar instruktorëve të FSK-së, kërkoi nga ta që të vazhdojnë me trajnime të mëtejme, të cilat më pas t'i praktikojnë nëpër njësitet tjera të FSK-së, "sepse kështu mund të bëheni shembull i mirë në nivel të njësitit, batalionit dhe më gjerë" . Ai, me këtë rast, tha se, edhe kërkesa e komandantit të FSK-së, gjeneral Ramës ka qenë shumë e qartë lidhur me udhëzimet e tij për Fitnesin Fizik si prioritet, i cili duhet të bëhet normë-standarde për nënoficerët dhe ushtarët e FSK-së. Në fund, mesazhi i gjeneral Halimit për instruktorët e FSK-së ishte "se vetëm me punë profesionale dhe këmbëngulëse mund të arrini rezultate të shkëlqyeshme dhe të bëheni shembull i mirë për të tjerët".



Ai edhe njëherë falënderoi ekipin e instruktorëve të Mbretërisë së Bashkuar për bashkëpunimin dhe ndihmën profesionale gjatë trajnimeve të fitnesit fizik. Ndërkaq, në emër të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, të gjithë të pranishmit i përshëndeti kolonel Perry, i cili në veçanti përgëzoi instruktorët ushtarakë të Mbretërisë së Bashkuar dhe ata të FSK-së, për paraqitjen dhe demonstrimin e shkëlqyeshëm të ushtrimeve gjatë këtij trajnimi. Ai kërkoi vazhdimin e ushtrimeve të tilla, me qëllim të arritjes së standardeve të NATO-s. Gjithashtu kolonel Perry, premtoi mbështetjen e FSK-së në këtë drejtim edhe në të ardhmen.



Në fund, gjeneral Halimi, kolonel Spahiu i ngarkuari me punë i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar Daniel Fearn, kolonel Perry, ndanë certifikatat e diplomimit për pjesëtarët e FSK-së dhe instruktorët e Mbretërisë së Bashkuar. Instruktorët britanikë për paraqitje të shkëlqyeshëm gjatë këtij trajnimi zgjodhën si më të mirin ushtarin Emir Vllasa, i cili nga Mbretëria e Bashkuar përfitoi një trajnim falas në Londër.

FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 50 • shtator 2016 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i FSK-së Haki Demolli priti drejtorin e Divizionit për Plane dhe Politika të NATO-s

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli më 24 gusht 2016, priti në takim një delegacion të NATO-s të kryesuar nga zotëri Paul Savereux, drejtor i Divizionit për Plane dhe Politika të Mbrojtjes së Aleancës.

Fillimisht, ministri Demolli e falënderoi delegacionin e NATO-s për angazhimin në ruajtjen e paqes në Kosovë dhe për kontributin që ka dhënë KFOR-i për sigurinë në vend, e gjithashtu edhe për punën e shkëlqyer të ekipeve këshilluese të NATO-s në MFSK dhe FSK, të cilat janë angazhuar në këshillime, ndarje përvojash e gjithashtu edhe në planifikim për të ardhmen.Më tej, ministri Haki Demolli tha se objektivi i Kosovës është që të promovojmë paqe në vend dhe më gjerë, si dhe objektivat tona të përputhen me vendet tjera të Bashkimit Evropian aty ku vendi ynë synon që të integrohet.Në veçanti, ministri Demolli në takim me delegacionin e lartë të NATO-ja tha se Republika e Kosovës është interesuar që ta thellojë bashkëpunimin me NATO-n, duke përmendur këtu iniciativën e Qeverisë dhe Kryeministrit të vendit dhe letrën që kryeministri Isa Mustafa i ka drejtuar NATO-s. Gjithashtu, ministri i FSK-së e njoftoi delegacionin e NATO-s edhe mbi rekomandimet e dala nga Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë, për punën që ka bërë Ministria për Forcën e Sigurisë dhe Forca e Sigurisë rreth hartimit të amendamenteve kushtetuese, pakos së ligjeve dhe planifikimin afatgjatë në drejtim të përgatitjes sa më të mirë të procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës(FAK), pas vendimit politik që pritet të merret nga institucionet më të larta të vendit, duke u shprehur se i tërë procesi që nga RSSS-ja dhe deri tani ka qenë një proces plotësisht transparent dhe se kështu do të vazhdohet edhe në të ardhmen.Në fund, ministri Demolli shprehu interesim për zgjerimin e këtij bashkëpunimit edhe me vende tjera, anëtarësimin në iniciativa rajonale dhe me gjerë duke theksuar se përkrahja e partnerëve strategjikë si e Shteteve të Bashkuara të



Amerikës(SHBA, Mbretërisë së Bashkuar(MB), Gjermanisë etj., ka qenë e duhura dhe se kjo pritet të zgjerohet edhe nga shtetet tjera në fushën e sigurisë në të ardhmen.Ndërsa, komandanti i Forcë së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama e njoftoi delegacion nga Brukseli për zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së, besueshmërinë e lartë që ka FSK-ja në opinionin vendor, si dhe mbi rritjen e kësaj besueshmërie edhe tek minoritetet që jetojnë në Kosovë e posaçërisht tek pakica serbe.Më tej, gjeneral Rama foli edhe për pjesëmarrjen e FSK-së në trajnime dhe ushtrime jashtë vendit, e sidomos në ushtrime rajonale të përbashkëta, ku FSK-ja sipas të gjitha raporteve po tregon profesionalizëm dhe ndërveprim me të gjitha ushtritë e vendeve pjesëmarrëse.Nga ana e tij, përfaqësuesi i NATO-s, z. Paul Savereux, drejtor i Divizionit për Politika dhe Plane në Aleancë tha se:,, NATO-ja është e përkushtuar për zhvillimin e Kosovës", kjo siç tha Ai u konfirmua edhe në Samitin e NATO-s të mbajtur në Varshavë të Polonisë.Nga ana e tij, z. Savereux përgëzoi ministrin Demolli dhe ekipin e tij, për punën që po bëjnë duke kumtuar se raportet nga NAT dhe NLAT të dërguara në Bruksel kanë qenë shumë pozitive për zhvillimin e MFSK-së dhe FSK-së.Në fund, kreu i delegacionit, z. Paul Savereux tha se transformimi i FSK-së në FAK varet nga shteti i Kosovës, duke shtuar se kjo duhet të bëhet në përputhje me mundësitë dhe nevojat e Kosovës, pra për të gjithë këtë proces dhe modalitetet vendos vetë Kosova.

NATO mandaton Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës për Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në

Në shtabin e KFOR-it në bazën „Film City" në Prishtinë, më 24 gusht u zhvillua ceremonia e ngritjes së Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe për vet Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në aktin solemn të mandatimit të NALT-it për MFSK/FSK-në, morën pjesë ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama, zëvendësministrat Fadil Gashi dhe MuhametLatifi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneralët: ZymerHalimi, Bashkim Jashari dhe NazmiBrahimaj si dhe drejtorë nga Ministria dhe komandantë dhe shefa të njësive të FSK-së.Me këtë rast, ministri Haki Demolli falënderoi



NATO-n dhe KFOR-in për angazhimin e tyre në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend, e në veçanti falënderoi NATO-n për përkujdesjen ndaj ngritjes së institucioneve vendore të sigurisë në Republikën e Kosovës.Më tej, ministri Demolli foli edhe për rolin dhe rëndësinë e dy ekipeve këshilluese të NATO-s për Ministrinë dhe Forcën (NAT/ NLAT) që nga viti 2009, të cilat siç tha ministri Demolli kanë pasur mision zhvillimin dhe profesionalizimin e Ministrisë dhe të FSK-së dhe pothuajse mision të „miqve ndër miq". Këshilltarët që kanë qenë këtu, shtoi ministri Demolli dhe të tjerët që janë këtu, por edhe ata që do të vijnë pas jush, janë vlerë për MFSK/FSK-në, sepse doktrina dhe standardet e NATO-s janë vlera mbi të cilat Kosova do ta ndërtojë sistemin e mbrojtjes.Në fund, ministri Demolli i dëshiroi punë të mbarë Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK-në, si dhe i siguroi ata për bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm edhe në të ardhmen.Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama në emër të FSK-së i falënderoi drejtorët e ekipeve këshilluese dhe këshilltarët e NATO-s për punën, angazhimin, kontributin si dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me FSK-në. Gjeneral Rama tha se vizioni dhe qëllimet tona të përbashkëta e bëjnë punën tonë mjaft të suksesshme dhe se ky koordinim e bashkëpunim do të jap frytet e veta në të ardhmen.Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i ndau drejtorit të Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në, gjeneral brigade ErnestHorn „Medaljen për Shërbim Vetëmohues" për kontributin e tij në krye të ekipit, si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer me FSK-në gjatë shërbimit të tij në krye të NLAT-it. Në ceremoninë e mandatitimit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe FSK-në folën edhe përfaqësuesit e NATO-s, zotërinjtë; PaulSavereux dhe MichelSoula, komandanti i KFOR-it, gjeneral major GuglielmoMiglieta, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade ErnestHorn, drejtori i NAT-it për MFSK-në, zotëri Dominic HaydnBraithwaite. Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s për Ministrinë dhe për FSK-në do të jetë trup këshillues dhe ndërlidhës ndërmjet NATO-s dhe Ministrisë për FSK dhe vet FSK-së. Drejtor i NALT-it, u emërua gjeneral brigade DietmarMosmann.

Ministri Haki Demolli ia uroi detyrën e drejtorit të NALT-it, gjeneralit Dietmar Mosmann


Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli më 30 gusht priti në takim drejtorin e sapoemëruar të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) për Ministrinë e FSK-së dhe për FSK-në, gjeneral brigade DietmarMosmann.

Fillimisht, ministri Demolli i uroi gjeneralit Mosmann detyrën në krye të NALT-it, duke i dëshiruar punë të mbarë, suksese dhe bashkëpunim e koordinim të mirë me stafin e MFSK dhe FSK-së, si dhe në përgjithësi mandat të suksesshëm për sa do të jetë në krye të Ekipit të NATO-s.Gjithashtu, ministri Haki Demolli shprehu konsideratë të lartë për Aleancën Veri atlantike, për kujdesin, interesimin dhe angazhimin e madh që ajo po tregon ndaj MFSK-së dhe FSK-së, duke qëndruar afër zhvillimit, profesionalizimit dhe përgatitjes së institucioneve tona për të ardhmen. Ministri Demolli e siguroi gjeneralin Mosmann për bashkëpunim të sinqertë, angazhim në përmbushjen e standardeve dhe kooperim të vazhdueshëm me drejtorin e NALT-it, e gjithashtu edhe me të gjithë oficerët ndërkombëtarë që do të punojnë për NALT-in. Nga ana e tij edhe drejtori i NALT-it për MFSK-në dhe FSK-në, gjeneral brigade Dietmar Mosmann u shpreh se misioni i tij dhe i Ekipit që ai drejton është mision këshillues dhe ndërlidhës i NATO-s me MFSK-në dhe FSK-në, i cili do të vazhdojë të qëndrojë afër Ministrisë dhe Forcës me këshilla dhe udhëzime.Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për Ministrinë dhe FSK-në, është i mandatuar nga NATO-ja. Drejtori i NALT, gjeneral brigade Dietmar Mosmann është i lindur në Bad Kreuznach, si dhe ka shërbyer në detyra të ndryshme në Bundesverin gjerman.

Sipas Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

FSK-ja tanimë e besueshme edhe për minoritetin serb

Forca e Sigurisë së Kosovës(FSK) tanimë ka rritje të besueshmërisë edhe nga minoriteti serb që jeton në Republikën e Kosovës, si dhe ruan shkallën e besueshmërisë tek qytetarët si një ndër institucionet më të besueshme në vend. Kjo u bë e ditur më 15 gusht 2016, në promovimin e numrit të katërt të vëllimit të parë të Opserverit të Sektorit të Sigurisë së Kosovës të zhvilluar nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave(KIPRED), ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve të vendit, kryesisht të fushës së sigurisë.Aktivitetin e promovimit të rezultateve të Observerit (KIPRED) e shpalli të hapur Lulëzim Peci, ndërsa raportin e rezultateve e paraqiti Mentor Agani, hulumtues i lartë në KIPRED. Sipas raportit të promovuar, Forca e Sigurisë së Kosovës sa i përket besueshmërisë sipas etnisë; besimin më të lartë në FSK e kanë shqiptarët, por vlen të përmendet këtu se krahasuar me shkurtin e vitit 2016, besueshmëria e komunitetit serb për Ministrinë e FSK-së dhe për FSK-në është rritur në shkallën prej 0.5 për qind për Ministrinë, përkatësisht 0.3 për qind për FSK-në.Rezultatet e hulumtimit të këtij raporti përfshijnë një periudhë kohore prej tre muajve, pra 15 mars deri më 15 korrik 2016, dhe siç u tha gjatë promovimit për FSK-në, fokusi kryesor ka qenë në dy tema kyçe: Çështja e transformimit të FSK-së dhe marrëdhëniet e Kosovës me NATO-n. Në diskutime të hapura për temën e sigurisë dhe punës së këtyre institucioneve diskutuan, z. FarukGeci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane në MFSK, deputetët: NuredinIbishi, Haxhi Shala dhe Duda Balje nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, si dhe Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Ndër të tjera, z. Geci, nga MFSK-ja, tha se është çështje imediate që institucionet më të larta vendore; Parlamenti dhe Qeveria e Kosovës të marrin masa në drejtim të nxjerrjes së vendimit dhe aplikimin e ndryshimeve të kërkuara sipas rekomandimeve të dala nga Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë së Kosovës(RSSSK), sepse në të kundërtën, vendnumërimi apo edhe ri-planifikimi nuk garantojnë motivim e aq më pak, besueshmërinë nga ana e qytetarëve; besueshmëri të cilën FSK-ja



e ka arritur me mund dhe po e mban vendin e parë për kaq vite me radhë.Në promovim morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve, si nga Ministria për FSK-në, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, FarukGeci, gjeneral brigade NazmiBrahimaj, shefi i Departamentit për Operacione dhe Trajnime në MFSK, Këshilli Kombëtar i Sigurisë, Policia e Kosovës, deputetë të Parlamentit të Kosovës dhe nga institucione tjera të sigurisë në vend.



Ministri Haki Demolli dekoroi zyrtarin e Ambasadës së SHBA-së Mishel Poljak

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli më 26 gusht, prit në një takim lamtumirësz. Mishel Poljak (Michael Polyak), zyrtar për Politika ushtarake në Ambasadën e SHBA-së në Prishtinë. Në takim ishin të pranishëm edhe ambasadori i SHBA-së, z. Greg Delavie, zëvendësministrat Fadil Gashi e Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së, drejtorë të departamenteve, përfaqësues të NALT-it, Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s dhe përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë.Me këtë rast, Ministri Demolli, në emër të Ministrisë dhe FSK-së, falënderoi z. Mishael Poljak për kontributin personal dhe profesional që ka dhënë për Ministrinë dhe FSK-në, në kuadër të bashkëpunimit të mirë dhe intensiv, gjatë kohë së qëndrimit të tij në Kosovë. Gjatë fjalës së tij, ministri Demolli ndër të tjera falënderoi edhe Ambasadën e SHBA-së, si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën e tyre të vazhdueshme për Kosovën dhe FSK-në. "U jam shumë mirënjohës për kontributin tuaj personal dhe mbështetjen e vazhdueshme për zhvillimin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjatë tërë kësaj kohe sa keni shërbyer në Kosovë".Ministri Demolli në shenjë respekti për punën, angazhimin dhe kontributin e z. Poljak, gjatë shërbimit të tij në Kosovë, e dekoroi me mirënjohje për "Shërbim të Shquar".Ndërsa nga ana e tij, z. Poljak falënderoi ministrin Demolli dhe personelin e FSK-së për bashkëpunimin e shkëlqyer që ata patën gjatë kohës së shërbimit të tij në Ambasadën e SHBA-së në Prishtinë.

Komandanti i KFOR-it qëndroi për vizitë lamtumirëse në MFSK

Zëvendësministrat Fadil Gashi e MuhametLatifi së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) gjenerallejtënant RrahmanRama, më 16 gusht pritën në një vizitë lamtumirëse komandantin e KFOR-it, gjeneral majorin Guglielmo Miglieta. Në takimin e përbashkët, zëvendësministri Fadil Gashi në emër të ministrit të FSK-së Haki Demolli, si dhe në emër të Ministrisë dhe në emrin e tij personal falënderoi gjeneralin Miglieta për kontributin, përkushtimin dhe angazhimin profesional gjatë kohës së shërbimit të tij në Republikën e Kosovës. Ai, përmes gjeneralit Migileta, falënderoi të gjithë ushtarët e KFOR-it, të cilët po kontribuojnë në ruajtjen e sigurisë dhe paqes në Kosovë. Njëherësh zëvendësministri Gashi, shprehu mirënjohjen e tij të thellë për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të MFSK-së me KFOR-it në përgjithësi. Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, falënderoi komandantin e KFOR-it gjeneralin Miglieta për kontributin e dhënë në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe KFOR-it, si dhe shprehu optimizmin se ky nivel i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke pasur parasysh aktivitetet e shumta dhe të përbashkëta stërvitore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe në mes FSK-së dhe KFOR-it.Nga ana e





tij, komandanti i KFOR-it, gjeneral majori Miglieta, nënvizoi se: "Bashkëpunimi KFOR-FSK ka qenë i shkëlqyer", duke potencuar sidomos ngritjen e shkallës së profesionalizmit dhe kapaciteteve për t'u përballur me emergjenca.Gjenerali italian Miglieta, i cili qëndroi në krye të KFOR-it për 13 muaj, tha se: "FSK-ja ka dëshmuar përgatitje dhe gatishmëri të lartë edhe me rastin e përfundimit me sukses të ushtrimit të përbashkët ,,Shpata e argjendtë" mbajtur gjatë këtij viti.Theksojmë se raportet e bashkëpunimit FSK-KFOR janë në nivel të lartë dhe se FSK-ja është ftuar të marrë pjesë me një tog, në ceremoninë e ndërrimit të Komandantit të KFOR-it, në fund të këtij muaji.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Intervistë me gjeneralin Enver Cikaqi- komandant i KDS-së në FSK

Gjeneral Enver Cikaqi kreu me sukses studimet në Kolegjin Mbretëror të Mbrojtjes në Londër

NT: Gjenerali Enver Cikaqi, gjatë karrierës ushtarake ka kryer shumë trajnime me sukses në shumë qendra me renome të mbrojtjes në Botë. Në SHBA ishte më i suksesshmi. Ndërsa në Kolegjin e Mbrojtjes në Londër u dallua për paraqitjen e tij të shkëlqyeshme. Pas kthimit nga Londra, zhvilluam një intervistë për gazetën e FSK-së "Forca Jonë"



Gazeta "Forca Jonë": *Gjeneral, Ju për një vit keni pasur fatin t'i kryeni studimet në Kolegjin Mbretëror të Mbrojtjes në Londër, kur dihet se shumë pak student të huaj, mund të përfitojnë nga ky shkollim, çfarë konkretisht mund të na thoni?*

Gjeneral Cikaqi: Konsideroj se është privilegj të jesh student i Kolegjit Mbretëror të Mbrojtjes (RoyalCollegeofDefenceStadies-RCDS) dhe unë ndihem i nderuar që kam pasur fatin të vijojë studimet e Mbrojtjes në këtë Kolegj me famë botërore. Pjesë e këtij institucioni akademik kanë qenë oficerë seniorë të armatave të 53 shteteve të ndryshme, diplomatë dhe personel që janë të lidhur ngushtë me institucionet më të larta të sigurisë në vendet e tyre. Për një vit më radhë, kam pasur mundësinë të përcjelli ligjërata të ndryshme nga personalitete të njohura të jetës akademike britanike dhe nga vende të ndryshme të Botës, por njëkohësisht edhe gjatë seminareve të shumta të shkëmbejmë ekspertizat tona si studentë, të cilat janë vlerësuar edhe nga stafi akademik i Kolegjit.Roli primar i Kolegjit Mbretëror për studime të Mbrojtjes është të zhvillojë mendimtarë dhe liderë strategjikë përmes një programi shumë të ngjeshur teoriko-praktik; bërja e strategjive dhe aplikimi i tyre bazuar në sfidat nacionale dhe multinacionale. Programi i shkollimit është një program i kombinuar, duke pasur parasysh tri elementet tradicionale të pushtetit, siç janë: instrumenti diplomatik, ushtarak dhe ai ekonomik. Konsideroj se, edhe pse kam kryer shumë shkolla dhe kurse të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, përvoja disavjeçare aktive në procesin e marrjes së vendimeve, padyshim se ky shkollim, më ka dhënë një mundësi të jashtëzakonshme të kuptojë më mirë procesin e të menduarit strategjik në rrethana të globalizmit dhe ndërvarshmërisë në mes të shteteve në kontekst të prosperitetit dhe sigurisë nacionale dhe globale.

Gazeta "Forca Jonë": *Gjeneral, cilat janë standardet e Kolegjit Mbretëror të Mbrojtjes për shkollim dhe sa është mundësia reale e shkollimit të oficerëve të huaj?*

Gjeneral Cikaqi: Kolegji Mbretëror i Mbrojtjes ka një histori (qindravjeçare) të gjatë të funksionimit, dhe ka një traditë dhe renome botërore. Këtu shkollohen shumë oficerë vendorë, por edhe nga shumë shtete të botës, me të cilat Mbretëria e Bashkuar ka bashkëpunim dhe marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Kolegjin Mbretëror për Studime të Mbrojtjes. Vendi ynë, përkatësisht Forca e Sigurisë së Kosovës falë një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, që nga viti akademik 2014/16 ka filluar shkollimin e oficerëve të lartë; dhe unë shpresoj shumë se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen, sepse është në interes shumë të madh për Kosovën. Padyshim, se për të qenë pjesë e këtij institucioni të lartë akademik, duhen plotësuar shumë kritere profesionale e akademike dhe sidomos duhen atribute reprezentative të kandidatit. Unë gjatë qëndrimit tim në Londër, jam munduar që në mënyrën më të mirë të mundshme ta përfaqësojë FSK-në dhe Kosovën. Forca e Sigurisë së Kosovës por, edhe institucionet tjera të sigurisë në Kosovë kanë kuadro që i plotësojnë këto kritere, andaj unë shpresojë shumë te miqtë tanë britanikë të vazhdojnë këtë bashkëpunim duke na dhënë mundësinë që të dërgojmë kandidatë tjerë gjatë viteve të ardhshme në Kolegj, që do të ishte shumë me rëndësi për përgatitjen e kuadrove të sektorit të sigurisë në Kosovë.

Gazeta "Forca Jonë": *Gjeneral, cilat janë fushat e studimit-hulumtimit në Kolegjin e Mbrojtjes dhe cili ishte koordinimi me studiuesit e shteteve tjera pjesëmarrëse?*

Gjeneral Cikaqi: Programi i Kolegjit është shumë i avancuar dhe ai rishikohet çdo vit në përputhje me kërkesat dhe sfidat që janë aktuale në Botë. Stafi akademik në bashkëpunim me studentët çdoherë japin rekomandimet e tyre për të freskuar programin me qëllim që të arrihen objektivat e programit akademik, në mënyrën sa më të suksesshme. Programi është i kombinuar përmes ligjëratave nga ligjërues të fushave ushtarake, politike, diplomatike, ekonomike e sociale; pastaj, përmes seminareve ku trajtohen tema të ndryshme të diskutimit, punimeve akademike, vizitave të shumta sociale studimore brenda dhe jashtë Britanisë, si dhe aktivitete të shumta sociale, që Kolegji organizon duke bërë të mundshme që të gjithë studentët dhe familjet e tyre pavarësisht nga vijnë të jenë shumë të shoqërueshëm me njëri-tjetrin. Gjatë vitit akademik kemi realizuar shumë vizita me karakter studimore, si brenda Mbretërisë së Bashkuar (në rajone të ndryshme) dhe vizita studimore në Selinë e Bashkimit Evropian, në Selinë e NATO-s, në Bruksel, pastaj vizita studimore në SHBA, përkatësisht në Kombet e Bashkuara në Nju Jork dhe në Uashington. Një nga pjesët më të rëndësishme të vizitave me karakter studimi, zhvilluar në anë të ndryshme të Botës, që si objektiv ka qenë shqyrtimi i perspektivave rreth stabilitetit, sigurisë dhe prosperitetit të këtyre rajoneve dhe implikimeve në sigurinë globale. Personalisht kam pasur fatin të jem pjesë e grupit studimor në Lindjen e Largët (Kore të Jugut, Japoni dhe Kinë). Për tri javë kemi pasur mundësinë të kemi takime me institucione të larta vendore por edhe nga të gjitha shtresat e popullsisë por edhe vizita në rajone të ndryshme në këto shtete, duke analizuar më shumë kujdes sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit në përgjithësi dhe këtyre vendeve në veçanti.

Gazeta "Forca Jonë": *Gjeneral, si ka qenë koordinimi i mësimeve teorike me ato praktike, në një kolegj me renome botërore, kur dihet se nga këtu kanë dalë udhëheqësh të shteteve dhe luftërave të suksesshme ?*


Gjeneral Cikaqi: Thash edhe më lartë se objektivi kryesor i programit akademik ka qenë bërja e liderëve strategjikë duke nxitur të menduarit strategjik si dhe bërja e strategjive të të gjitha niveleve duke pasur parasysh "fuqinë e fortë, të butë dhe të mençur" (Hard, Soft andsmart-power). Sot, Bota ballafaqohet me shumë sfida të cilat kanë ndikim të jashtëzakonshëm tek secili shtet dhe bërja e strategjive efikase është prioritet i secilit shtet. Andaj, Kolegji Mbretërorë për Studime të Mbrojtjes secilit student ia ka dhënë mundësinë të njohë shumë mirë të gjitha problemet dhe sfidat në rajone të ndryshme të Botës, duke marrë shembuj nga strategjitë e suksesshme, por, edhe ato që kanë dështuar. Dëshiroj të theksojë se shumë liderë ushtarakë e politikë që kanë përfunduar studimet në këtë Kolegj të Mbrojtjes kanë pasur paraqitje të jashtëzakonshme, ku përmes lidershipit të tyre kanë qenë pjesë e zgjidhjeve të shumë konflikteve, mosmarrëveshjeve etj.

Gazeta "Forca Jonë": *Gjeneral ju keni përfituar një përvojë të lartë nga ligjërues me renome botëror, sa do jeni në gjendje, duke pasur parasysh faktor tjerë, që këto njohuri t'i zbatoni me sukses në institucionin që punoni?*

Gjeneral Cikaqi: Përgjatë një viti akademik Kosova është përmendur shumë herë nga ligjërues të ndryshëm por edhe në debate gjatë realizimit të seminareve. Kosova si një çështje ndërkombëtare të viteve 90-ta e trajtuar në kuadër të Doktrinës së Përgjegjësisë për të Mbrojtur (Responsibility to Protect-R2P), është marrë si shembull i suksesit të Bashkësisë Ndërkombëtare. Natyrisht se edhe prezenca ime atje, ka bërë të mundur që të ofrohen informacione dhe fakte historike, por edhe të realitetit që ka ndodhur dhe proceseve që ka kaluar dhe që po ndodhin në vendin tonë. Vlerësoj, se ekspertiza e marrë në Kolegj, do të më ndihmojë shumë në punën time dhe do të mundohem që në çdo aspekt të japë kontributin tim për të avancuar Forcën e Sigurisë në veçanti dhe vendin tonë në përgjithësi. Ka shumë hapësira për të dhënë kontributin tim dhe unë do të jem përkrahë Komandantit të Forcës së Sigurisë dhe Ministrit të Forcës së Sigurisë për të dhënë kontributin tim në përputhje me dijen dhe përvojën e fituar në Kolegjin Mbretëror për studime të Mbrojtjes.

Gazeta "Forca Jonë": *Gjeneral , në fund, cili është mesazhi juaj në përgjithësi?*

Gjeneral Cikaqi: Konsideroj, se secili nga Ne, kemi për detyrë të punojmë shumë në forcimin e Institucionit tonë të Forcës së Sigurisë, të marrim përvojat e miqve tanë që na i ofrojnë përmes shkollave dhe akademive të tyre, me renome, t' i gërshetojmë me përvojat tona dhe gjithsesi t'i aplikojmë ato, për të forcuar stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e vendit tonë dhe në rajon. Në këtë mënyrë Ne dërgojmë mesazh të fuqishëm tek miqtë tanë amerikanë dhe evropianë se investimet e tyre janë duke u përdorur në vend të duhur dhe në mënyrën e duhur. FSK-ja përmes sistemit të shkollimit dhe trajnimit të ndërtuar në kuadër të Komandës së Trajnimit dhe Doktrinës të FSK-së, si dhe ndihmës që na ofrojnë miqtë tanë përmes vendeve të ofruara në Akademi dhe qendrat e tyre të trajnimit, ka arritur një nivel të lartë të performancës dhe unë besojë fuqishëm që shumë shpejtë do të bëhen ndryshimet e nevojshme kushtetuese për të ndryshuar misionin tonë në mënyrë që të marrim detyra dhe përgjegjësi të reja në të mirë të stabilitetit dhe sigurisë që padyshim është edhe një hapë i madh edhe drejt prosperitetit ekonomik. Kjo mund të arrihet përmes fuqizimit të partneritetit strategjik me miqtë tanë, fqinjësisë së mirë, si dhe punës së palodhshme dhe reprezentative të secilit nga Ne brenda dhe jashtë Kosovës.



Ekipi i parashutistëve të FSK-së në 'Javën ndërkombëtare të hedhjes me parashutë ushtarake' në Gjermani

Ditë më parë,u kthye ekipi i parashutistëve të FSK-sënga Gjermania, ku mori pjesë në një trajnim ndërkombëtar për parashutistë, në Bazën e Forcave Ajrore të SHBA-ve në Ramstein të Gjermanisë. Ata i përgëzoi edhekomandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama për paraqitjen e suksesshme të tyre.



Në Bazën e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në Ramstein të Gjermanisë, nga data 24deri më 29 korrik 2016, u mbajt "Java ndërkombëtare e hedhjes me parashutë ushtarake". Në këtë garë ndërkombëtare, me ftese të Forcave Ajrore të SHBA-së, mori pjesë edhe ekipi i parë i parashutistëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Kjo ngjarje tashmë është aktivitet tradicional, i cili organizohet çdo vit në këtë bazë ushtarake dhe në të cilin marrin pjesë vende të NATO-s dhe vende tjera aleate. Këtë vit për herë të parë mori pjesë edhe Kosova-FSK-ja, përkrah ekipeve të SHBA-së, Anglisë, Gjermanisë, Francës, Holandës dhe Izraelit.Qëllimi i kësaj ngjarje është; demonstrimi i kapaciteteve të parashutizmit, njohja me procedurat, me parashutat, me mjetet fluturuese të vendeve pjesëmarrëse, ashtu si edhe familjarizimi dhe shkëmbimi i përvojave përkatëse. Gjithashtu është synimi i secilit që në këtë ngjarje të mbledhë sa më shumë krahë të vendeve, të cilat certifikojnë dhe dhurojnë krahë të parashutistëve. Bazuar në rregullat e certifikimit dhe dhënies së krahëve të parashutizmit, këtë vit certifikues ishin: SHBA, Gjermania dhe Izraeli.Kushtet për dhënien e certifikatës dhe krahëve të parashutizmit janë si më poshtë: Ushtaraku parashutist duhet të ketë së paku një kërcim nga një mjet fluturues ushtarak i vendit përkatës, të kërcejë me parashutën e vendit përkatës, të kërcejë nën instruksionet e një mjeshtri të hedhjes të vendi përkatës, etj. Pjesëtarët e FSK-së i përmbushën të gjitha këto kushte dhe prandaj u certifikuan nga të tri vendet certifikuese. Ekipi i FSK-së, në bashkërendim me stafin e Grupit për Reagim në Kriza (Njësi e Forcave Ajrore të SHBA-së), dhe drejtpërdrejt të kolonelit Jerzy Zubr nga Ushtria e SHBA-së, ka arritur që të hedhet me parashutë dhe të certifikohet nga tri vendet certifikuese; pra me këtë rast, duhet të theksohet se ekipi i FSK-së, me meritë ka arritur të fitojë dhe mund të bart me krenari krahët e SHBA-së, Gjermanisë dhe Izraelit.Ekipi i parashutistëve të FSK-së, i përberë nga togeri Ilir Beqiri (udhëheqës), tetar Labinot Kelmendi, tetar Faton Rukovci, ushtar FranjoKodraj dhe ushtar Besarta Pacolli. Togeri Ilir Beqiri, udhëheqës i Ekipit të FSK-së, pas kthimit nga Gjermania, ku kishte marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishëm të parashutizmit për FSK-në, thotë: "Për ne, ka qenë me rëndësi pjesëmarrja në këtë ngjarje ndërkombëtare krahas parashutistëve të SHBA-së, Gjermanisë, Anglisë, Francës, etj., duke pasur parasysh, që ne jemi në fazën fillestare të krijimit të ekipit të parashutizmit. Pas pjesëmarrjes në Kroaci, kjo është hera e dytë për ekipin e parashutistëve të FSK-së, të cilët treguan dashuri, guxim, dije dhe angazhim maksimal. Të gjithë pjesëtarët e FSK-së, arritën që t'i kryejnë ushtrimet dhe lëshimet nga aeroplanët-helikopterët, gjatë javës ndërkombëtare të parashutizmit në Qendrën Amerikane në Gjermani. Në këtë ngjarje, ekipin e FSK-së, e ka shoqëruar koloneli amerikan JerzyZuber, shef i Zyrës për Bashkëpunim në Mbrojtje nga Ambasada Amerikane në Kosovë, i cili po ashtu është hedhur me parashutë. Edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka përcjellë me interesim parashutistët e FSK-së duke u lëshuar me aeroplanë amerikanë, së bashku me ushtarët nga SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Holanda, Franca dhe Izraeli. Gjenerali Rama me këtë rast i ka përgëzuar parashutistët e FSK-së, për guximin si dhe për arritjet e tyre profesionale, duke marrë parasysh se ky është vetëm ushtrimi i tyre i dytë në të cilin ata po marrin pjesë. Ekipi i parashutistëve të FSK-së, ka marrë mirënjohje për kryerjen me sukses të trajnimeve në Qendrën e Forcave Ajrore të SHBA-se, mbajtur në Ramstein të Gjermanisë.





Pakti Atlantik i Rinisë së Kosovës e nderoi me mirënjohje Komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramën



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Rrahman Ramamë 9 gusht prit një delegacion të Asociacionit të Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës-KYATA (Kosovo Youth Atlantic Association) të udhëhequr nga kryetari i saj, z. Besim Salihu.Qëllimi i vizitës së delegacionit të këtij asociacioni ishte dhënia e Certifikatës / Mirënjohjes komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRamës, me motivacion për mbështetjen e ofruar gjatë realizimit të aktiviteteve të kësaj organizate si dhe promovimit të vlerave euro-atlantike tek rinia e Kosovës. Gjatë dorëzimit të Mirënjohjes, kryetari i këtij Asociacioni, z. Salihu falënderoi komandantin e FSK-së, gjeneral Rama falënderoi Asociacionin e Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës për bashkëpunim, si dhe shprehi gatishmërinë e FSK-së, për përkrahjen e iniciativave që kanë për qëllim forcimin e vlerave euroatlantike tek Forca e Sigurisë së Kosovës, dhe bashkëpunimin rajonal në procesin e ndërtimit të një ambient të paqes, sigurisë dhe integrimit në NATO.

Nënkolonel Haki Hoti me sukses kreu Kolegjin e Luftës në Akademinë e Mbrojtjes në Gjermani



Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të Ministrisë për FSK-në dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë dhe në përputhje me Urdhëresën dhe marrëveshjen në mes të dy ministrive, nënkolonel Haki Hoti (Departamenti për Politika dhe Plane në Ministrinë e FSK-së) për 18 muaj ndoqi shkollimin në Kolegjin e Luftës në Akademinë e Mbrojtjes në Hamburg të Gjermanisë. Kolegji i Luftës në Akademinë e Mbrojtjes së Gjermanisë është institucioni me i lartë për përgatitjen e oficerëve të lartë për Lidership, Menaxhim dhe Udhëheqje në nivelet operative dhe strategjike. Bazuar në raportin e vlerësimit dhe të Diplomës së Kolegjit të nënshkruar nga Ministria e Mbrojtjes dhe komandanti i Akademisë gjeneralmajor Lidsba, tregon se performanca e nënkolonel Hotit, është e shkëlqyeshme. Ai është një oficer me inteligjencë shumë të lartë, me karakter të fortë dhe mirë të formësuar e të balancuar dhe me ambicie të shëndetshme. Përkushtimi, Vendosmëria, Disiplina dhe Vullneti janë karakteristikat dalluese të tij që në çdo kohë shkëlqejnë.Sipas raportit nënkolonel Hoti ka treguar dhe performuar kapacitete intelektuale të gjykimit të shëndoshë edhe në kohë me presion të lartë, ai arrin rezultate të shkëlqyeshme të punës, dhe tregon shpirtin dallues dhe të shquar ekipor dhe aftësi të mëdha komunikimi. Në aspektin e paraqitjes, nënkolonel Hoti është një person me vetëbesim të madh, i sjellshëm dhe i thjeshtë. Gjatë debateve ai mbron mendimet e veta objektivisht dhe në mënyrë të argumentuar. Vendi i tij duhet të jetë shumë krenar sepse ai është krenar që është një oficer i FSK-së. Nënkolonel Hoti është i aftë të veprojë në mënyrë shumë konfidente në mjedise internacionale, i cili në një mënyrë shumë të veçantë integroi vetën me studentet tjerë internacional të kolegjit. Ai ishte gjithmonë i gatshëm t'i ndihmojë kolegët e tij, gjithashtu ai gëzonte një simpati të veçantë dhe ishte më i respektuari dhe më popullor mes kolegëve të tij. Bazuar në qëndrimin, paraqitjen, sjelljen dhe suksesin e shkëlqyeshëm të treguar gjatë takimeve të niveleve të ndryshme, qofshin; seminareve, prezantimeve, provimeve dhe punimeve të seminareve, nënkolonel Hoti përfaqësoi denjësisht Forcat e Armatosura dhe shtetin e tij. Ai është një ushtarak i motivuar me aftësi të shkëlqyeshme dhe të veçanta, i cili ka dhënë një performancë të mrekullueshme përgjatë kolegjit. Pjesëmarrja e tij në Akademinë e Mbrojtjes edhe vizita në Bruksel ka qenë shembullore. Ai ishte nder i madh për Akademinë e Mbrojtjes, gjatë gjithë kohës. Ai u familjarizua shumë lehtë me procesin e marrjes së vendimeve dhe procesin e Planifikimit të Forcave Tokësore të Ushtrisë Gjermane ato të NATO-s dhe të OKB-s. Gjatë ushtrimeve fushore në nivel Brigade, Divizioni dhe Korpusi me skenar të Operacioneve të intensitetit të lartë, të mesëm dhe forma të ndryshme të Operacioneve ai performoi shkallë të lartë të aftësive dhe të Liderit. Duke marrë parasysh performancën dhe personalitetin e tij, ai përmbushi me sukses të veçantë si shembull për të tjerët të gjitha kriteret e Kolegjit të Luftës. Në modulin e fundit të Kolegjit që kishte të bëjë me Sigurinë Evropiane dhe NATO-n, (një pjesë e të cilit u realizua në selinë e NATO-s dhe BE-s), performanca e tij ishte mbresëlënëse jo vetëm për Kolegjin dhe mësimdhënësit por edhe për oficerët madhor të NATO-s pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe Parlamentarëve Evropian në Bruksel. Nënkoloneli Haki Hoti më 17 korrik 2016, diplomoi dhe iu kthye punës së rregullt në Departamentin për Politika dhe Plane në Ministrinë e FSK-së) ku vazhdon me sukses kryerjen e detyrave të përgjithshme.

"Bexhin e Zotësisë" e fituan 27 pjesëtarë të FSK-së në një garë të organizuar nga Forcat e Armatosura Gjermane



Në ambientet e kazermës ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) u mbajt më 3 gusht 2016, ceremonia e ndarjes së çmimit ,,Bexhi i Zotësisë" organizuar nga Forcat Ushtarake Federale të Gjermanisë."Bexhi i Zotësisë" është një shenjë e dukshme, për njohjen e shërbimit të jashtëzakonshëm ushtarak dhe të niveleve sportive për të gjithë ushtarët aktivë dhe rezervë të forcave të armatosura gjermane, si dhe pjesëtarëve të forcave mike. Kjo garë në Forcat e Republikës Federale Gjermane, organizohet që nga viti 1971. Për të fituar këtë titull, ushtarët duhet t'i nënshtrohen shumë sfidave dhe shumë disiplinave; punës me stres dhe ngarkesave fizike dhe psikike që të jenë të denjë për një medalje që do t`u shërbej në karrierën e tyre dhe e cila tregon përgatitjen e tyre ushtarake e fizike.Në ceremoni të pranishëm ishin zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i NLAT-it (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, për FSK-në) gjeneral brigade ErnestHorn, zëvendëskomandanti i komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes kolonel Irfete Spahiu, zëvendëskomandanti i Brigadës Mbështetëse Operacionale (BMO) kolonel AvdiRaci, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) kolonel ShaipHaziri, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së dhe NLAT-it. Me këtë rast, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, theksoi se "sot jemi në një ceremoni të shkëlqimit dhe të ngritjes së vlerave, ku dita-ditës po vlerësojmë të arriturat e pjesëtarëve tanë, pa dyshim që ky rezultat i arritur dhe rezultatet e treguara në këto testime për arritjen ose marrjen e ,,Bexhit të Zotësisë" të ushtrisë Gjermane, kanë një vlerë të jashtëzakonshme për FSK-në. Kjo garë do të jetë një standard i ri, që do të thotë se ne në të ardhmen do të nxjerrim një standard tonin".Gjeneral Hazrolli falënderoi përmes gjeneralit Horn Gjermaninë dhe stafin e tij, për mundësinë që i ofruan FSK-së, këtë garë, për të fituar "Bexhin e Zotësisë".Në fund, gjeneral Hazrolli, në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRamës përshëndeti të gjithë pjesëtarët e FSK-së, të cilët fituan këtë titull.Nga ana e tij, drejtori i NLAT-it, gjenerali ErnestHorn duke falënderuar për mundësinë që i është dhënë që sot të flasë dhe të shpërndajë medaljet e ,,Bexhit të Zotësisë" për pjesëtarët e FSK-së, të cilët treguan aftësitë e tyre ushtarake. Kjo garë organizohet në Forcat e Republikës Federale Gjermane, tash e 45 vjet, që nga viti 1971, njoftoi gjenerali Horn, për të shtuar se "Qëllimi i këtij "Bexhi" ishte që të iniciohet një shenjë e dukshme për njohjen e shërbimit të jashtëzakonshëm ushtarak dhe të niveleve sportive për të gjithë ushtarët aktivë dhe rezervë të forcave të armatosura gjermane si dhe pjesëtarët e forcave mike pa marrë parasysh a janë nga armata, marina apo forcat ajrore".Ai bëri një përshkrim historik të kësaj gare, duke treguar në detaje disiplinat të cilave duhet nënshtruar pjesëtarët për t`u pajisur me këtë bexh. "Për sfidat të cilat duhet kaluar ushtarët në të gjitha disiplinat, punën me stres, me ngarkesa fizike e psikike që të jenë të denjë për një medalje që do t`u shërbej në karrierën e tyre dhe e cila tregon përgatitjen e tyre ushtarake e fizike".Në fund të fjalës së tij, gjenerali Horn edhe një herë falënderoi FSK-në dhe udhëheqjen e saj për bashkëpunimin që kanë pasur në përudhën e tij, të shërbimit në Kosovë dhe FSK, duke theksuar se: "do të përcjellë tek pasardhësi im, që të vazhdohet me këtë garë të përgatitjes dhe vlerësimit të aftësive ushtarake në kohë paqeje". Vlen të theksohet se kjo garë është organizuar nga Forcat e Republikës Federale Gjermane dhe është realizuar në disiplinat: Testimi fizik, ndihma e parë (shpëtimi i jetës së njerëzve në beteja), not, marshim, testi i MKAB-së (Mbrojtja Kimike-Atomike dhe Biologjike) dhe qitja me armë-revole. Garës për të fituar titullin ,,Bexhi i Zotësisë" iu nënshtruan 50 pjesëtarë të FSK-së, ku nga ta 27 pjesëtarë e fituan këtë titull: 10 pjesëtarë fituan ,,Bexhin e artë" 16 ,,Bexhin e argjendtë" dhe një pjesëtarë fitoi ,,Bexhin e bronztë.

Gjenerali Xhavit Gashi, atashe i FSK-së në SHBA, pensionohet nga FSK-ja

Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), më 18 gusht 2016, mbajti një ceremoni zyrtare me rastin e pensionimit vullnetar të gjeneral brigade XhavitGashit, atashe i Forcës së Sigurisë të Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Në fjalën përshëndetëse, z/ministri Fadil Gashi në emër të ministrit Haki Demolli dhe të Ministrisë i dorëzoi medaljen ,,Shërbim i shquar", duke e falënderuar gjeneral Gashin për shërbimin në Ministri dhe në Forcën e Sigurisë si dhe për kontributin e tij dhënë në diplomacinë ushtarake gjatë shërbimit si atashe i FSK-së në Uashington. Më tej, z/ministri Gashi, tha se puna, profesionalizmi dhe përkushtimi i pareshtur i gjeneral Gashit, gjatë viteve të shërbimit të tij, ka ndikuar në të mirë të avancimit dhe progresit të gjithmbarshëm në FSK, e sidomos në detyrën e atasheut të FSK-së në SHBA, ku ka ndikuar në forcimin dhe avancimin e marrëdhënieve në mes të Ministrisë së FSK-së dhe SHBA-së në fushën e sigurisë. Nga ana e tij komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama i ndau gjeneral Gashit ,,Medaljen e karrierës" me rastin e përfundimit të shërbimit aktiv në uniformë.Ndër të tjera, gjatë fjalës së tij, gjeneral Rama tha: ,,Personalisht gjeneral Gashin e kam njohur gjatë kohës së luftës për liri, në ditë shumë të vështira për vendin. Më vonë kemi shërbyer së bashku në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Për gjatë gjithë këtyre viteve, gjeneral Gashi ka treguar përkushtim, profesionalizëm si dhe ka dhënë kontribut të madh, sidomos me rastin e përfaqësimit të FSK-së në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe forcimit të bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Ajovës". Ndërkaq, gjenerali XhavitGashi tha: ,,Sado që kam emocione në këtë ditë, më shumë kam krenari dhe falënderime për të gjithë ju, që më mbështetët, por më së shumti për mundësitë që mi keni dhënë për të ardhur deri këtu". Ai gjithashtu shtoi se: ,,Nuk mund të harroj mbështetjen e vazhdueshme që kam pasur nga lidershipi, në çdo punë që kam kryer. Jam i pari nga Kosova që kam



pasur mundësinë të jem në këtë pozitë sot, dhe e gjitha kjo, jo për shkak timin por thjesht për shkak të mundësive që më janë dhënë nga vendi im". Në fund, gjeneral Gashi, tha se: ,,Dua të kujtojë të gjithë ata djem dhe vajza që ranë në altarin e lirisë, të gjithë ata që në forma të ndryshme kontribuuan ndër dekada, që neve në përgjithësi, por në këtë rast dua të them, mua ma dhanë mundësinë të jem ushtar i Kosovës, oficer i Kosovës dhe ta kem nderin ta përfaqësojë ushtrinë dhe vendin tim në SHBA dhe përmes SHBA-së në vende të ndryshme të botës". Në ceremoni morën pjesë edhe zëvendësministri Muhamet Latifi, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane Faruk Geci, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj- shef i Departamentit për Operacione dhe Trajnime, ambasadorja e Republikës së Kosovës në Uashington, znj. Vlora Çitaku, atasheu ushtarak i SHBA-së në Kosovë, koloneli ChadButs, drejtori i Ekipit Ndërlidhës Këshillues të NATO-s, gjenerali Ernest Horn, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), koloneli Naim Haziri, familja e gjeneral Gashit, atashetë e FSK-së; kolonel Xhavit Sadrijaj dhe nënkolonel Bekim Osmani, si dhe oficerë të lartë të FSK-së. Xhavit Gashi ka filluar karrierën e tij ushtarake në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pastaj ka shërbyer në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës në detyra të ndryshme, si dhe në Forcën e Sigurisë të Kosovës, ku fillimisht ka qenë drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Siguri dhe katër vitet e fundit ka kryer detyrën e atasheut të FSK-së në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me gradën gjeneral brigade. Gjeneral Gashi u pensionuar para kohe vullnetarisht, për të vazhduar karrierën e tij, në jetën civile.

Intervistë e shefit të Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore dhënë Radios Evropa e Lirë

Kolonel Haziri: FSK-ja ka kapacitete për emergjenca në Kosovë dhe jashtë saj

"Forca e Sigurisë se Kosovës është e gatshme të reagojë në situata emergjente apo në rast të fatkeqësive natyrore si në Kosovë ashtu edhe në rajon, krahas trupave të NATO-s"-kështu ka thënë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, kolonel NaimHaziri - shef i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Ai ka thënë se kjo forcë ka kapacitete të mjaftueshme dhe të specializuara për raste të tilla.

Radio Evropa e Lirë: Kolonel, sa është e gatshme FSK- ja në raste të emergjencave apo edhe fatkeqësive natyrore?
Kolonel Naim Haziri: Misioni primar që ka FSK-ja është që t'i përgjigjet kërkesave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në reagim në situata emergjente. Bazuar në vlerësimet, analizat pas-vepruese që janë bërë edhe të reagimeve reale në fatkeqësi, por edhe në ushtrimet fushore që i realizojmë në funksion të ushtrimit të kapaciteteve tona, në reagim në situata të tilla, ne vlerësojmë dhe besojmë fuqishëm që Forca e Sigurisë se Kosovës është e gatshme, e përgatitur mjaftueshëm dhe e trajnuar që të ballafaqohet më fatkeqësitë natyrore më të cilat mund të ballafaqohet Republika e Kosovës.

Radio Evropa e Lirë: Cilat janë kapacitetet e FSK-së, kolonel?
Kolonel Naim Haziri: Brenda strukturës organizative të FSK-së, është Regjimenti i Mbrojtjes Civile, i cili brenda saj ka të strukturuara njësitë e specializuara, të cilat reagojnë në situata të ndryshme si Njësia e kërkim-shpëtim në ujëra, në male, deminim në fushë, deminim humanitar etj., të cilat reagojnë të parat në situatat emergjente, të mbështetura edhe nga batalionet e reagimit të shpejtë, të cilat mbulojnë rajonet e Mitrovicës dhe Pejës, të cilat janë të stacionuara në Istog dhe Gjilan. Baza kryesore e reagimit është te njësitet e specializuara të Regjimentit të Mbrojtës së Sigurisë.

Radio Evropa e Lirë: A keni makineri apo pajisje të mjaftueshme?
Kolonel Naim Haziri: Kemi pajisje të mjaftueshme, bazuar në kapacitetet njerëzore dhe profesionale që i kemi të angazhuara. Mirëpo, për çdo ditë, pajisjet modernizohen dhe ne si FSK, po tentojmë që vazhdimisht të ndjekim trendin e zhvillimit të teknikës në këto njësi të specializuara.



Radio Evropa e Lirë: Sa është numri i pjesëtarëve që marrin pjesë në këto raste?
Kolonel Naim Haziri: Forca e Sigurisë së Kosovës numëron gjithsej 2500 pjesëtarë, ndërkaq vetëm njësitë e specializuara janë pjesë e formacionit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile.

Radio Evropa e Lirë: Sa jeni të gatshëm që t'i dilni në ndihmë kërkesave të vendeve fqinje, por edhe më larg?
Kolonel Naim Haziri: FSK-ja ka mision reagimin brenda dhe jashtë vendit, varësisht nga kërkesat. Ne e kemi dëshmuar edhe në të kaluarën se me kapacitet tona jemi të gatshëm që të mbështesim edhe shtetet në rajon. Këtë e kemi dëshmuar më reagimet që i kemi pasur në Republikën e Shqipërisë, dy herë gjatë vërshimeve të cilat kanë ndodhur në rajonin e Shkodrës.Forcat tona kanë arritur qe në një afat të shkurtër kohor të dislokojnë banorët dhe të sanojnë situatën në Republikën e Shqipërisë, gjatë vërshimeve që kanë qenë.Prandaj, ne besojmë fuqishëm se me kapacitetet që kemi mund t'i dalim në ndihmë jo vetëm vendit tonë, por edhe shteteve të rajonit, për sa i përket mbështetjes tokësore. Ndërsa në qoftë se duhet të lëvizim në një distancë më të madhe atëherë kërkohet mbështetja edhe me pajisje ushtarake. Realisht, nuk mungon edhe gatishmëria e shteteve të NATO-s të cilat operojnë në Kosovë për të na mbështetur në këtë drejtim.

Radio Evropa e Lirë: Është kërkuar disa herë përfshirja e FSK-së, për ndihma krahas trupave të NATO-s në vende të caktuara, çka është bërë në këtë drejtim?
Kolonel Naim Haziri: FSK-ja gjithherë është treguar e gatshme që të jetë pjesë e trupave të NATO-s, atëherë kur paraqitet nevoja. Mirëpo, deri më tani, ne nuk kemi pasur ndonjë ofertë konkrete për t'ju bashkangjitur këtyre trupave. Kemi qenë pjesë e ushtrimeve në testim të kapaciteteve të përbashkëta, qoftë tonat apo ato në koordinim dhe sinkronizim me ushtritë tjera. Kurse, në ndonjë reagim konkret të përbashkët nuk kemi marrë pjesë, përveçse në Republikën e Shqipërisë.

Radio Evropa e Lirë: Do të thotë jeni të gatshëm të merrni pjesë krahas trupave të NATO-s nëse kërkohet?
Kolonel Naim Haziri: Absolutisht, absolutisht po. Në çdo moment që kërkohet, Forca e Sigurisë se Kosovës është e gatshme të marrë pjesë në çdo situatë që paraqitet në kuadër të misionit tonë.

FSK-ja dhuroi mbi 500 doza gjak



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës dje përfundoi aksioni humanitar i dhurimit vullnetar të gjakut, me moton: "Një pikë gjak, për shpëtimin e një jete". Aksioni u organizua nga Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Departamenti i Mjekësisë i MFSK-së, dhe u realizua nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës dhe nga Kompania Mjekësisë e FSK-së. Aksioni për dhurimin e gjakut ka filluar më 16 gusht në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe ka vazhduar deri më 31 gusht, dhe u realizua në të gjitha njësitet e FSK-së. Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut në MFSK është miratuar nga ministri Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Edhe përkundër kohës së pushimeve vjetore pjesëtarët e FSK-së dhe shërbyesit civilë në MFSK-në dhe FSK iu përgjigjen aksionit vullnetar për dhurimin e gjakut në të gjitha njësitet e saj, ku përgjatë dhjetë ditëve, për aq sa vazhdoi aksioni, u grumbulluan mbi 540 doza gjak."FSK-ja tashmë ka bërë traditë organizimin e aksioneve për dhurimin e gjakut në nivel vendi, duke qenë njëherësh edhe donatori kryesor i saj, dy herë brenda vitit",- tha drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në MFSK, z. Harjush Kurtaj. Ndërsa, mjekja dr. Kymetane Bela, e cila e udhëhoqi aksionin humanitar, u shpreh mjaft e kënaqur me përkrahjen e pjesëtarëve të FSK-së dhe stafit civil të MFSK-së gjatë këtij aksioni. Vlen të përmendet se pjesëtarët e FSK-së gjatë dy aksioneve të këtij viti, aksioni të shkurtit dhe atij të gushtit, kanë dhuruar mbi 1240 doza gjak për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës.

FSK-ja fitoi trofeun në turnirin e futbollit në kampin ushtarak ,,Bondsteel”

Ekipi i futbollit i Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë(BRSH) i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK) fitoi garën, zuri vendin e parë, pasi që në finale mundi ekipin e futbollit të Kontingjentit portugez të KFOR-it, në turnirin e organizuar në Kampin Ushtarak të Brigadës Shumëkombëshe Lindje të KFOR-it, ,,Bondsteel"në Sojevë të Ferizajt. Pjesëtarët e Batalionit të parë të BRSH-së, kishin fituar vendin e parë edhe në garat e organizuara më 4 korrik, për nderë të Ditës së Pavarësisë së SHBA-së, në Kampin Bondsteel. Gara e futbollit ishte e organizuar me sistem eliminimi, në të cilin morën pjesë shtatë ekipe, siç ishin: ekipi i futbollit i Kontingjentit amerikan në kuadër të KFOR-it, Kontingjentit gjerman, portugez (me dy ekipe), turk dhe atij kroat, të gjitha të stacionuara në kampin ,,Bondsteel" si dhe një ekip tjetër i futbollit nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së. Në ndeshjen finale, ekipi i futbollit i Batalionit të Parë të BRSH-së, mundi ekipin e futbollit të Kontingjentit portugez të KFOR-it, me rezultat 2:1. Tri vendet e para u shpërblyen me medalje nga organizatori, gjithashtu vendi i parë (BAT 1) përpos medaljeve është shpërblyer edhe me një trofe. Me këtë rast, Batalioni i Parë falënderoi organizatorin, pra kampin ,,Bondsteel" për mundësin e dhënë që edhe ata të jenë pjesë e këtij turneu, si dhe falënderoi të gjitha ekipet e KFOR-it, që garuan në turnir për mikpritje dhe lojë ,,fer- play".Organizimi dhe mbajtja e aktiviteteve të tilla sportive ka për qëllim ruajtjen e formës fizike, ngritjen e moralit dhe kalitjen e pjesëtarëve që shërbejnë në uniformë, të institucioneve pjesëmarrëse. Vlen të theksohet për fund se bashkëpunimi si dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me kampin ,,Bondsteel" janë të vazhdueshme dhe në fusha të ndryshme, qoftë në aspekt të trajnimeve, qoftë në ato të rekreacionit.



Kapiten Sahit Goxhuli varroset me nderime të larta ushtarake



Sot në fshatin e tij të lindjes, në Makërmal të Skenderajt, u varros me nderime të larta ushtarake kapiten Sahit Goxhuli, ish-pjesëtar i Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së në Istog. Kapiteni Sahit Goxhuli për në banesën e tij të fundit u përcoll nga Togu Ceremonial i FSK-së, pjesëtarët e Batalionit të tij dhe të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, kolegë të tij të shumtë, nga Rifat Jashari, deputetë të Kuvendit të Kosovës, komunarë, familjarë e veteranë, si dhe shumë qytetarë të Skenderajt, Drenasit dhe të Kosovës. Nga ora 15:00-16:00, arkivoli me trupin e kapiten Goxhulit ishte vendosur në hollin e Shkollës Profesionale në Skenderaj, ku u bënë homazhe, në nderim të tij, kurse nga ora 17:00 filloi ceremonia e varrimit në fshatin Makërmal. Në këtë ceremoni të pranishëm ishin edhe zëvendësministrat e MFSK-së, Fadil Gashi e Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahamam Rama, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci si dhe oficerë dhe nënoficerë të shumtë të MFSK/FSK-së.Në emër të FSK-së, nënkolonel Mehmet Lladrovci (komandanti i Batalionit të Dytë të BRSH-së) i shprehu ngushëllime familjes, pjesëtarëve të FSK-së, shokëve dhe kolegëve dhe më pas, foli për jetën dhe veprën e kapiten Sahit Goxhulit, ku ndër të tjera, tha: "Sahiti një jetë të tërë ia kushtoi çështjes kombëtare; lirisë dhe ndërtimit të Forcës, për të cilën populli ynë punoi dhe sakrifikoi ndër shekuj. Për këtë, Ai iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës qysh në fillim duke qenë i vetëdijshëm plotësisht se rruga e vetme për çlirim ishte rruga e luftës së armatosur. Si pjesëtar i saj, luftoi dhe udhëhoqi luftëtarët drejt realizimit të ëndrrës shekullore të popullit tonë për një Kosovë të lirë dhe të pavarur". Ndërsa pas çlirimit të vendit Sahiti nuk e ndali punën dhe angazhimin e tij në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës për ndërtimin e themeleve të Ushtrisë së ardhshme të Kosovës.Në fund, Nënkolonel Lladrovci tha: " Sahiti ishte shembull për të tjerët për gatishmërinë dhe vullnetin për të ndërtuar kapacitetet ushtarake të Forcës; për punën, disiplinën, profesionalizimin dhe angazhimin në përmbushjen e detyrave. Si komandant i tij, ndjej krenari të madhe që pata një oficer të zotin i cili dha një kontribut të çmuar në ngritjen dhe profesionalizimin e Batalionit të Dytë të BRSH-së, dhe në përgjithësi të FSK-së. Ndërsa, në emër të veteranëve të luftës të Skenderajt foli kryetari Hysni Ngucati, i cili ndër tjera tha, se Sahit Goxhuli në moshë të re iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare në Brigadën 113 Mujë Krasniqi, ku si pjesëtar i saj mori pjesë në shumë beteja dhe i cili do të mbetet shembull i një ushtari luftëtar për brezat e ardhshëm. Më pas, në emër të familjes të pranishmit i falënderoi Shaip Goxhuli. Në fund të ceremonisë, mbi varrin e kapiten Goxhulit, zëvendësministrat Gashi dhe Latifi, gjeneral Rama, gjeneral Brahimaj, kolonel Haziri dhe Geci, vendosen kurora lulesh, kurse djalit të tij, 9 vjeç, ia dorëzuan Flamurin e Republikës së Kosovës me të cilin trupi i Sahitit u përcoll për në banesën e fundit.



Sahit Goxhuli u lind më 24.02.1977 në fshatin Makërmal, Komuna Skenderaj. Shkollimin fillor e kreu në fshatin e lindjes, të mesmen në Skenderaj, kurse studimet në Shkencat Politike i kreu në Universitetin e Prishtinës. Sahiti ishte pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ku veproi në Brigadën 113 "Mujë Krasniqi" të Zonës Operative të Drenicës. Pas transformimit të UÇK-së inkuadrohet në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në Gardën e Kosovës. Në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) Sahiti shërbeu në Batalionin e Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, me gradën Kapiten. Si pjesëtarë i FSK-së, Sahiti ka dhënë një kontribut të çmuar në ngritjen dhe profesionalizimin e saj. Kapiten Sahit Goxhuli pas vetës la gruan dhe dy fëmijë; vajzën 11 vjeçe dhe djalin 9 vjeç. Kapiten Sahit Goxhulin ndërroi jetë më10. 08. 2016, si pasojë e një aksidenti.

GUSHT-FOTOKOLAZH NGA AKTIVITET E FSK-së













FORCA JONË

□□□ Viti V □ Nr. 51 □tetor 2016 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

FSK-ja përuroi Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), me një ceremoni madhështore të organizuar më 28 shtator 2016, në kazermën "Evropianët e rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, në Bardh të Vogël (Pomozatin), në të cilën mori pjesë edhe i pari i vendit, presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, si dhe në prani të shumë të ftuarve, përuroi Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, e para e këtij lloji në FSK, por edhe në Kosovë. Me këtë rast, presidenti i vendit, njëherë Komandant i Përgjithshëm i FSK-së, z. Hashim Thaçi tha se, Kosova duhet të krenohet me zhvillimin e Forcës së saj, dhe se FSK-ja do të jetë Ushtri e Kosovës në të ardhmen duke theksuar se: "FSK-ja është tregues më i mirë i karakterit të shtetit dhe shoqërisë sonë. FSK-ja po forcohet gradualisht në drejtim të mirëmbajtjes së kapaciteteve operacionale, të gatishmërisë për mbështetje të institucioneve, të komuniteteve, të OJQ-ve dhe të bashkëpunimit më partnerët tanë". Ndërsa, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, fillimisht falënderoi të gjithë partnerët, si Suedinë, SHBA-të dhe Turqinë që kanë ndihmuar rreth ngritjes së Qendrës së Trajnimit, gjithashtu falënderoi edhe partnerët nga Ekipi i Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s, që kontribuuan gjatë këtij procesi shumë të rëndësishëm për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Karakteristikë dalluese e kësaj Qendre, theksoi ministri Demolli, është fakti se përveç pjesëtarëve të FSK-së dhe shtetasve të Kosovës, në përgjithësi do të trajnohen edhe shtetasit e huaj, të vendeve fqinje nga regjioni, ata të NATO-s si dhe student nga të gjitha vendet që duan të përfitojnë profesionalisht nga kapacitetet e Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së, "andaj shfrytëzojë rastin, që t'iu dëshirojë mirëseardhje të posaçme të gjithë atyre, që do të vijnë nga jashtë Kosovës për të vijuar trajnimet në këtë Qendër trajnimi. Ministri Demolli, në fund premtoi angazhim dhe përkrahje për kapacitetet e Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, duke theksuar se: "Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës është angazhuar, do të angazhohet, si edhe financiarisht do të përkrahë ngritjen e aftësive të kërkim-shpëtimit".

Kurse komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama foli për sukseset në drejtim të avancimit të kapaciteteve duke paraqitur me këtë rast edhe rolin, rëndësinë dhe objektivat e FSK-së për Qendrën e trajnimit për Kërkim-Shpëtim. "Qendra e Trajnimit të Kërkim-Shpëtimit



ka për objektiv të jetë qendër e ekselencës për ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, dhe njëkohësisht trajnimin e pjesëtarëve të agjencive tjera emergjente të vendit tonë dhe të vendeve të rajonit në fushën e kërkim shpëtimit". Më tej, Ai, tha se: "Falë angazhimit të madh dhe profesionalizimit të gjithë pjesëtarëve, FSK-ja po dëshmon çdo ditë, që jemi forcë profesionale, e përgatitur, dhe e motivuar në shërbim të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim, dhe e gatshme të kontribuoj në sigurinë regjionale dhe globale". Gjeneral Rama në fund të fjalës së tij, falënderoj dhe përgëzoj të gjithë ata të cilët kanë kontribuar në ngritjen e kësaj Qendre, dhe uroj për një punë të mbarë në të ardhmen, duke veçuar posaçërisht ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e qendrës, komandantin e Regjimentit të Mbrojtjes Civile, dhe gjithë personelin e FSK-së, që ndihmuan dhe kontribuuan në ngritjen e kësaj qendre si dhe partneret, e në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Suedinë dhe Turqinë, të cilët dhanë një kontribut të çmuar në logjistikë, mjete financiare, pajisje dhe këshilla profesionale, dhe kanë mundësuar ngritjen profesionale të njësisë së Kërkim-Shpëtimit dhe në ngritjen e kësaj Qendre.

Vijon në faqen 2

Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerali Hodges: FSK-ja e gatshme pret vendimin politik për transformim

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur sot në takim zyrtar komandantin e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e ka njoftuar gjeneralin Hodges me të gjitha të arriturat e FSK-së, si dhe përgatitjet për transformimin e FSK-së në Forca të armatosura të Kosovës (FAK). Gjithashtu, gjenerali amerikan Hodges ka shprehur mbështetjen për FSK-në, në vizionin e saj, duke ofruar përkrahje për nevojat më specifike në rrugën e zhvillimit dhe profesionalizimit të mëtejshëm. Për gjeneralin Hodges dhe delegacionin amerikan, në Ministri, në një takim të gjerë, nënkolonel Agron Bajrami prezantoi temën: "FSK dhe procesi i transformimit të saj", si dhe kolonel Ilir Qeriqi i cili informoi për bashkëpunimin ndërkombëtare me vendet tjera dhe partneritetin e ndërtuar me sukses deri më tani. Komandant i Komandës së Ushtrisë së SHBA-ve për Evropë, gjenerallejtënant



Ben Hodges së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahaman Rama, vizituan edhe Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së, ku u prit nga komandanti i QSU-së, major Avni Kiqina. Gjenerali Hodges në Qendrën për Studime Universitare mbajti një ligjëratë dhe bashkëbisedoj lirshëm me kadetët tanë. Ai ka lavdëruar punën e FSK-së dhe udhëheqjen e saj, duke thënë se të rinjtë në FSK edhe pse kanë pas mundësinë për zgjedhje të ndryshme në jetë, ata kanë zgjedhur që t'i shërbejnë vendit për një të ardhme më të ndritur. Veç tjerash, Ai tha se talentin që ka parë te këta pjesëtarë, ka bërë që ai të jetë optimist për Kosovën, duke theksuar që FSK-ja do jetë ajo që do ta zhvillojë shtetin e Kosovës. Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges në konferencën për media, tha se kadetët të cilët i ka takuar janë e ardhmja e Kosovës. "Dua që të shikoni prapa meje. Kjo është e ardhmja e Kosovës. Këta djem dhe vajza të jashtëzakonshëm këtu të cilët edhe pse kanë pasur zgjedhje të tjera kanë dalë vullnetarë për të kontribuar për vendin e tyre. Në SHBA ushtria ka pasur impaktin më të madh për të bashkuar njerëzit. Po ashtu mendoj që nën udhëheqjen e gjeneral Ramës, dhe këtë kapacitet që keni këtu, FSK-ja do të zhvilloj Kosovën".

Gjithashtu, gjenerali Hodges për FSK-në u shpreh: "Çfarë unë kam parë nga ushtarët e FSK-së është impresive. Dje në Shqipëri në ushtrimet që i kemi bërë së bashku, kam parë ushtarë të rinj që janë të përgatitur dhe të motivuar. Mendoj që tashmë keni bërë disa aktivitete shpëtuese në Shqipëri, andaj tashmë ju keni marrë një vendim për transformimin, ta mbështes edhe Parlamenti. Kur të jetë koha, gjeneral Rama tashmë e ka bërë punën e tij dhe kur të merret vendimi politik, FSK-ja do të jetë gati. Dua të inkurajo; që ju në Kosovë të shfrytëzoni secilën mundësi që të shkolloheni udhëheqësit e së ardhmes sikur këta kadetë këtu" tha në fund, gjenerali amerikan Hodges. Komandanti i Komandës së Ushtrisë së SHBA-ve për Evropë, gjeneral Hodges i shoqëruar nga komandanti i FSK, gjeneral Rama dhe delegacionet e tyre kanë vizituar Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, ku nga komandanti i saj, kolonel Shaip Haziri janë njoftuar me misionin detyrat dhe kapacitetet operacionale të njësive të specializuara të Regjimentit të Mbrojtjes Civile si dhe rreth përgatitjeve për përurimin e Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të Regjimentit të Mbrojtjes Civile. Në stacionin e Kërkim-Shpëtimit urban, vetë gjenerali Hodges mori rolin e një të aksidentuari, siç tha edhe vet Ai, për të provuar aftësitë dhe pajisjet e FSK-së. Pas sprovës ai deklaroj që: "Unë i provova vet aftësitë dhe pajisjet tuaja duke pas besim në aftësitë tuaja, pajisjet dhe profesionalizmit tuaj".

Ministri Haki Demolli priti drejtorin e Politikave Ndërkombëtare të Sigurisë të Ministrisë së Mbrojtjes të Britanisë së Madhe, Nick Gurr

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, zotëri Haki Demolli, më 23 shtator 2016, priti në takim, drejtorin për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes(MM) të Britanisë së Madhe, z. Nick Gurri cili shoqërohej nga ambasadori RuairiO'Connell, atasheu britanik i akredituar për Kosovë, nënkolonel RichardParry si dhe këshilltari i Komandantit nënkolonel Andy Layton. Ministri Demolli e falënderoi delegacionin britanik për gjithë angazhimin që Qeveria, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Britanisë së Madhe kanë dhënë në drejtim të mbështetjes së vendit tonë, në rrugëtimin për ndërtimin dhe profesionalizimin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës.Ministri i FSK-së, Haki Demolli gjithashtu u shpreh mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme që Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Britanisë së Madhe, në kuadër të marrëveshjes dypalëshe kanë ofruar dhe po vazhdojnë të ofrojnë në fushën e arsimimit dhe përgatitjes profesionale, si me trajnime apo këshillime, që kanë ndikuar në perspektivën e Forcës së Sigurisë. Ministri Demolli, po ashtu e njoftoi z. Gurr me zhvillimet e përgjithshme në MFSK dhe FSK, si dhe me planet për të ardhmen e FSK-së, e në veçanti me procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.Nga ana e tij, drejtori për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes të Britanisë së Madhe, zotëri Nick Gurr u shpreh se interesimi i Britanisë për Kosovën vazhdon edhe më tutje, ashtu si edhe për shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor.Më pas, ai



shtoi se e gëzon fakti i bashkëpunimit të shkëlqyer me FSK-në, sidomos në ngritjen profesionale të pjesëtarëve, duke përmendur, me theks të veçantë, oficerët e FSK-së që kanë ndjekur shkollimin dhe trajnimet në Britani të Madhe. Më pas, delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes të Britanisë së Madhe, në krye me z. Nick Gurr zhvilloi një takim edhe me gjeneral brigade Zymer Halimin, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, me të cilin biseduan mbi aktivitetet, trajnimet, operacionet si dhe planet dhe sfidat e FSK-së për të ardhmen.

Komandanti i FSK-së, u prit në Romë nga shefi i Forcave të Armatosura të Italisë



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant RrrahmanRama me ftesë të shefit të Forcave të Armatosura të Italisë, gjenerallejtënant Danilo Errico, më 26 shtator 2016, qëndroi për vizitë zyrtare në Romë, ku zhvilloi një varg takimesh dhe vizitash me interes të përgjithshëm. Fillimisht, gjenerallejtënant Rrahman Rama u prit në takim nga shefi i Ushtrisë, gjenerallejtënant Danilo Errico, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Italisë në Romë.Gjatë takimit, të dy shefat, gjeneralët Rama dhe Errico, biseduan për marrëdhëniet e mira ndërmjet dy vendeve, sidomos për marrëdhëniet në fushën e sigurisë ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Italisë, si dhe për vazhdimin dhe thellimin e këtyre marrëdhënieve edhe në të ardhmen.Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama e falënderoi gjeneralin Errico për kontributin që Forcat e Armatosura të Italisë po japin për sigurinë dhe paqen në Kosovë, dhe në veçanti për kontributin e tyre në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së. Gjeneral Rama, në vazhdim shprehu vizionin e vendit tonë si një vend që synon të promovojë stabilitet dhe paqe, jo vetëm për qytetarët e saj, por, edhe për regjionin dhe Evropën në përgjithësi, duke theksuar faktin se Kosova aspiron që të jetë pjesë integrale e strukturave të sigurisë në regjion dhe më gjerë. Gjithashtu, gjeneral Rama tha se FSK-ja është profesionale, shumetnike, Forcë e motivuar dhe nën kontrollin demokratik civil dhe ju shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës. FSK-ja, shtoi, gjeneral Rama në takim, po merr pjesë në stërvitje të përbashkëta në disa vende, së bashku me ushtritë tjera dhe se po tregon profesionalizëm dhe shkallë të lartë të motivimit dhe ndërveprimit.Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama u shpreh gjithashtu se Kosova në fushën e sigurisë ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë vende, dhe se synimi i Kosovës është që edhe me Italinë të kemi të marrëveshje të tilla, për çka, siç tha ai, pala kosovare është e gatshme.Në fund të takimit, gjeneral Rama e njoftoi shefin e Ushtrisë së Italisë, gjeneralin Errico, rreth procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.Nga ana e tij, shefi i Forcave të Armatosura të Italisë, gjenerallejtënant DaniloErrico u shpreh i gatshëm për vazhdimin e bashkëpunimit dhe intensifikimin e tij në të ardhmen.

Ushtarakë të Gardës Kombëtare të Ajovës vizituan Ministrinë për FSK-nëdhe Komandën e Forcave Tokësore

Një delegacion prej 61 ushtarakësh të rangjeve të ndryshme të Gardës Kombëtare të Ajovës të ShBA-së, në krye me gjeneralët Steven Altman dhe William De Haes, u pritën më 13 shtator, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë dhe në Komandën e Forcave Tokësore.Vizita e delegacionit të gjerë të ushtarakëve amerikanë nga Garda Kombëtare e Ajovës, ka për qëllim forcimin e partneritetit strategjik dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, si dhe zgjerimin e njohurive të ushtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Flotës Ajrore lidhur me historinë e Republikës së Kosovës.Fillimisht, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, iu dëshiroi mirëseardhje ushtarakëve amerikanë në Republikën e Kosovës, përkatësisht në Ministrinë për Forcën e Sigurisë.Më tej gjeneral Rama, gjatë fjalë se tij, tha se, kjo vizitë është e mirëseardhur dhe do të ndikojë në njohjen tonë reciproke, gjithashtu do të ndikojë edhe në vazhdimin dhe forcimin e marrëdhënieve tona dypalëshe dhe të partneritetit me Ajovën dhe Shtetet e Bashkuara në përgjithësi. Në vazhdim, gjeneral Rama paraqiti një ekspoze të shkurtër mbi zhvillimin, profesionalizimin dhe përgatitjet e FSK-së lidhur me transformimin e saj në Forca të Armatosura të Kosovës.Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama falënderoi delegacionin e ushtarakëve amerikanë për vizitën, si dhe përmes tyre Gardën Kombëtare të Ajovës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe Komandën e Ushtrisë Amerikane për Evropë, për mbështetjen e pakursyer dhënë Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Republikës së Kosovës në përgjithësi.Në takimin me ushtarakët amerikanë nga një ekspoze mbajtën edhe nënkolonel Agron Bajrami, shef i Departamentit për Transformim dhe rreshter majori i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, Fetah Zejnullahu. Gjeneralët amerikanë, kryesues të delegacionit të ushtarakëve amerikanë nga Garda Kombëtare e Ajovës, të shoqëruar nga mikpritësi, gjeneral brigade



Enver Cikaqi- komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitje, vazhduan më pastaj vizitën në Komandën e Forcave Tokësore të FSK-së, në kazermën „Adem Jashari" në Prishtinë, ku u njohën nga afër me misionin, detyrat dhe aktivitetet e Qendrës për Studime Universitare të FSK-së.Delegacioni i Gardës Kombëtare të Ajovës gjatë qëndrimit në Kosovë vizitoi qytetin e Prizrenit dhe Batalionin e Tretë të Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë dhe në disa vende të tjera me rëndësi kulturore dhe historike.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Haki Demolli takoi gjeneralët amerikan Altman dhe De Haes nga Garda Kombëtare e Ajovës



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli,më 13 shtator, priti në takim gjeneralin Steven Altman dhe gjeneralin William DeHaes nga Garda Kombëtare e Ajovës,të cilët shoqëroheshin nga komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së-gjeneral brigade Enver Cikaqi. Në fillim, ministri Demolli falënderoi gjeneralët e Gardës së Ajovës për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet MFSK/ FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, si dhe për mbështetjen që Garda amerikane po jep për FSK-në në përgjithësi, sidomos në fushën e arsimimit dhe stërvitjes profesionale të pjesëtarëve të FSK-së.

Më tej ministri i FSK-së, Haki Demolli, i njoftoi gjeneralët Altman dhe DeHaes mbi zhvillimet në FSK dhe marrëdhëniet e saj me partnerët, e në veçanti mbi përgatitjet rreth procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Ministri Demolli tha se, gjithashtu, mbështetja e SHBA-së si partner strategjik i Republikës së Kosovës dhe i MFSK-së, është mjaft e rëndësishme edhe në të ardhmen, sidomos në drejtim të ngritjes dhe forcimit të institucioneve të sigurisë së vendit.Takimi i ministrit me gjeneralët amerikanë, u zhvillua në kuadër të vizitës së një delegacion prej 61 ushtarakësh, të rangjeve të ndryshme nga Garda Kombëtare e shtetit të Ajovës. Vizita e delegacionit të ushtarakëve amerikanë ka për qëllim forcimin e partneritetit strategjik, rritjen e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, si dhe zgjerimin e njohurive të ushtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Flotës Ajrore amerikane për historinë e Republikës së Kosovës.

Betohen kadetët e rinj të FSK-së



Në kazermën ,,Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), në Prishtinë, më 30 shtator u zhvillua ceremonia solemne e betimit të kadetëve, të cilët janë pranuar këtë vit akademik në Qendrën për Studime Universitare (QSU). Ceremonia nisi me intonimin e himnit të Republikës së Kosovës. Në fjalën e hapjes së ceremonisë, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, duke ju drejtua kadetëve të rinj, tha: ,,Që nga sot, ju do të jeni në studime që dallojnë dukshëm nga studimet e moshatarëve tuaj. Ju sot po e filloni shkollimin tuaj, i cili do t'ju bëjë të dobishëm dhe të vlefshëm jo vetëm për vetën tuaj, por edhe për popullin, institucionet dhe shtetin tonë në përgjithësi".Më tej, Ministri Demolli theksoi se FSK-ja është e përkushtuar dhe se objektiv i saj është ndërtimi i një force profesionale, moderne të sigurisë, të trajnuar mirë dhe të pajisur me infrastrukturë sipas standardeve të Aleancës Veri -Atlantike. Për ta arritur këtë, ministri Demolli tha se nuk mjafton vetëm dëshira dhe përkushtimi i pjesëtarëve, por duhet edhe ngritja e lartë profesionale dhe arsimore, e cila mund të arrihet vetëm përmes shkollimit dhe trajnimit të kuadrove të reja në akademi dhe institucione bashkëkohore ushtarake.Në fund të fjalës së tij, ministri Demolli, iu drejtua edhe familjarëve të kadetëve: ,,E di që edhe ju jeni krenarë për sukseset e djemve dhe vajzave tuaja. Prandaj shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj për mbështetjen që iu keni ofruar fëmijëve tuaj, respektivisht kadetët tonë, në realizimin e synimeve dhe dëshirave të tyre, që të bëhen kadetë, pra oficerë të vendit. Uroj që ndonjëri prej tyre në të ardhmen të bëhet edhe oficerë i lartë i Forcave të Armatosura të Kosovës.Nga ana e tij, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi foli mbi rolin, rëndësinë dhe traditën e shkollimit të kadetëve në FSK. Gjeneral Cikaqi tha se nga QSU-ja deri më tani kanë diplomuar dhe shërbejnë në FSK 85 oficerë, të cilët janë duke bërë një punë të shkëlqyer nëpër njësitë e tyre. Në vazhdim, gjeneral Cikaqi tha se qëllimi i programit të edukimit dhe shkollimit të kadetëve, është të zhvillojë udhëheqës me karakter dhe kompetencë. Në fund të fjalës së tij, gjeneral Cikaqi përgëzoi edhe stafin e QSU-së për punën dhe përkushtimin e pareshtur në edukimin dhe kalitjen e oficerëve të rinj të FSK-së. Ndër 16 kadetë të pranuar këtë vit njëri është nga Republika e Shqipërisë. Kadetët do të studiojnë edhe në Universitetin Amerikan në Prishtinë, dhe pas katër vitesh, pra në vitin 2020, do të dalin në detyrë me gradën e nëntogerit.

FSK-ja prezantoi Planin e Integritetit

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj, më 15 shtator në takimin me anëtarët Grupit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, prezantuan Planin e Integritetit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Takimin e udhëhoqi Daut Haradinaj kryetar i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, fillimisht paraqiti një ekspoze të zhvillimit, profesionalizimit dhe aktiviteteve të FSK-së, duke përmendur të arriturat në fushën e arsimimit, të trajnimit, të stërvitjes, e gjithashtu edhe pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrime të përbashkëta jashtë vendit, si në regjion dhe më gjerë, krahas ushtrive të tjera partnere. Gjeneral Rama i njoftoj deputetët e Komisionit edhe me arritjet rreth integrimit të minoritarëve, po ashtu foli për investimet që janë bërë për përgatitjen e tyre profesionale, si dhe për planet dhe synimet e Forcës së Sigurisë drejt rrugëtimit të saj të transformimit në Forca të Armatosura, për çka komandant Rama tha se ju takon institucioneve më të larta të vendit të marrin vendim politik. Ndërsa për Planin e Integritetit si dhe për funksionimin e suksesshëm të administratës në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, raportoi para deputetëve sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj. Ai, ndër të tjera tha, se Plani i Integritetit i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës është promovuar më 30 qershor 2016, dhe ka filluar të zbatohet që nga 1 korriku i këtij viti, dhe se, siç tha ai, për vijimin e implementimit të tij do të raportohet në vazhdimësi, ashtu siç edhe parashihet.Në fund të fjalës së tij, Sekretari Sylaj tha se Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës qëndrojnë të përkushtuara për arritjen e standardeve të NATO-s. Kurse nënkoloneli Sefer Isufi prezantoi më gjerësisht objektivat dhe propozimet e Planit të Integritetit, procesin mbi të cilin është hartuar si dhe partnerët dhe përvojat e vendeve që kanë përkrahur dhe ndihmuar hartimin e Planit të Integritetit të MFSK-së. Gjatë takimit, deputetët, të cilët janë edhe anëtarë të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, mirëpritën hartimin e Planit të Integritetit si dhe shtruan një varg pyetjesh për të cilat komandanti i FSK-së dhe sekretari i përgjithshëm u përgjigjen me kompetencë. Plani i Integritetit paraqet dokumentin parimor të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me qëllim të reduktimit të rreziqeve korruptuese në institucion, dhe është në përputhje të plotë me bazën ekzistuese ligjore të Republikës së Kosovës, e cila promovon qeverisjen e mirë dhe parimin e meritës në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shpenzimet e parasë publike.



FSK-ja përuroi Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim

(Vijon nga faqja parë)

Ndërsa, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, kolonel Shaip Haziri tha se qëllimi i ngritjes së Qendrës është që të ofrojmë trajnime për kërkim-shpëtim prej më të mirave në Evropë, dhe ky është, dhe do të jetë qëllimi i ekipit të trajnimit në këtë Qendër. Para demonstrimeve, presidenti i vendit Hashim Thaçi, ministri i FSK-së Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe kolonel Shaip Haziri prenë shiritin dhe bënë përurimin e Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim. Në fund të gjithë të pranishmit, përcollën nga afër demonstrimin e aftësive dhe shkathtësive të pjesëtarëve të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në përgjigje profesionale ndaj disa skenarëve me situata të cilat kërkuan reagim emergjent për shpëtimin e viktimave të shkaktuara nga tërmeti në situatën e simuluar. Regjimenti i Mbrojtjes Civile i Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së, komandon dhe drejton njësitë e Kërkim-Shpëtimit, Deminimit dhe Eliminimit të Mjeteve të Pashpërthyera Eksplozive, Mbrojtjen Kimike-Biologjike dhe Atomike si dhe Njësinë e Zjarrëfikjes. Qendra e trajnimit për Kërkim-Shpëtim e RMC-së ka për mision trajnimin dhe profesionalizimin e pjesëtarëve për përballje me emergjenca të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore si dhe emergjenca tjera. Synon edhe trajnimin e agjencive tjera vendore që merren me këtë fushë dhe mëton të jetë Qendër Rajonale e Ekselencës për kërkim-Shpëtim. Në këtë ceremoni morën pjesë zëvendës ministri i FSK-së, Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralët, Zymer Halimi, Gëzim Hazrolli, Bashkim Jashari, Nazmi Brahimaj dhe Enver Cikaqi, komandanti i Trupave Paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë (KFOR), ambasadorë, atashe ushtarak, krerë të Policisë së Kosovës, përfaqësues të agjencive dhe organizatave joqeveritare si dhe mysafirë të shumtë.

Nga data 19-29 shtator në Shqipëri u mbajt stërvitja ushtarake "Joint Effort-16"

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama në stërvitjen e përbashkët 'Joint Effort-16' në Shqipëri





Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama përgëzoi Batalionin e Dytë të Reagimit të Shpejtë të FSK-së, për suksesin e treguar në stërvitjen "Joint Effort-16".

Mbi 1500 trupa ushtarake po marrin pjesë në stërvitjen e përbashkët "Joint Effort-16" organizuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe njësitet ushtarake të Forcave të Armatosura të SHBA-ve, Britanisë së Madhe, Italisë, FSK-së dhe Malit të Zi. Stërvitja e cila ka filluar nga data 19 shtator 2016, është njëra ndër stërvitjet e përbashkëta më të mëdha që FA kanë zhvilluar me NATO-n, në dhjetë vitet e fundit në Shqipëri.

Qëllimi i zhvillimit të stërvitjes ushtarake "Joint Effort-16"është rritja e ndër veprueshmërisë ndërmjet forcave pjesëmarrëse dhe kapaciteteve operacionale të shtabeve dhe njësive të FA në procesin e planëzimit dhe ekzekutimit të operacioneve luftarake në mjedis të përbashkët (JOINT) dhe multinacional, në nivel taktik dhe operativ.

Në "Ditën e Vizitorëve të Shquar" të pranishëm ishin ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, anëtarët e Komisionit Parlamentar të Sigurisë, komandanti i Komandës së Ushtrisë së SHBA-së për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i Kosovës në Republikën e Shqipërisë, z. Ramiz Lladrovci, atasheu i FSK-së, nënkolonel Enver Dugolli, ambasadori i Britanisë së Madhe, Duncan Norman, komandantët e forcave, atashe ushtarakë si dhe oficerë të lartë të shteteve pjesëmarrëse.

Në fjalën e saj ministrja e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë znj. Mimi Kodheli vlerësoi se mjedisi i përbashkët i sigurisë kërkon një përqasje gjithëpërfshirëse dhe kontribut të përbashkëta, të cilat kanë nevojë për më shumë bashkëpunim dhe mirëkuptim si dhe për besim reciprok midis vendeve."Kërcënimet e sotme në kufijtë lindorë dhe jugorë të Aleancës dëshmojnë rëndësinë e mirë përgatitjes së saj për përballimin e çdo rreziku. Për pjesëmarrësit e FARSH kjo stërvitje është në funksion të përmbushjes së detyrimeve, pasi i shërben drejtpërdrejt përgatitjes për certifikimin e grup - batalionit pas disa vitesh. Stërvitja "Joint Effort - 2016" është një mundësi e mirë jo vetëm për përmirësimin e aftësive të mirëfillta ushtarake, por edhe një mundësi e mirë për të promovuar bashkëpunimin rajonal dhe atë dypalësh, si dhe çuarjen përpara të marrëdhënieve në aspektet politike dhe diplomatike, pa lënë mënjanë dhe promovimin dhe shkëmbimet kulturore të vendeve", tha ministrja e Mbrojtjes.

Po ashtu nuk mund të lë pa përmendur edhe Forcat nga Kosova, të cilët nuk mungojnë asnjëherë duke na dhënë kënaqësinë e veçantë që përveç aleatëve të kemi edhe partner po aq të përgatitur, me eksperiencë dhe dinjitozë si vëllezërit tanë kosovarë", vlerësoi ministrja Kodheli.

Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pas stërvitjes; vlerësoi lartë pjesëmarrjen e Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, në Stërvitjen "Joint Effort-16" së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shteteve tjera pjesëmarrëse. Gjeneral Rama më tej tha se: "me këtë stërvitje FSK-ja demonstroi profesionalizmin të lartë, përkushtimin dhe motivimin. Ai gjithashtu përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për suksesin e treguar, disiplinën dhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me ushtritë pjesëmarrëse në stërvitjen "Joint Effort -16".

Nga ana e tij shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Jeronim Bazo nënvizoi se e reja e kësaj stërvitjeje është fakti se është shumëkombëshe dhe zhvillohet në vendin tonë.

Kurse gjenerali amerikan Hodges nënvizoi se "Shqipëria është shumë e rëndësishme për Aleancën, është pjesë e rëndësishme e stabilitetit në rajon dhe po i tregon kapacitetet e veta Aleancës për operacionet". Stërvitja e koduar "Joint Effort -16" e cila filloi nga data 19 dhe përfundoi më 29 shtator 2016.

Paraqitje e shkëlqyeshme e Kontingjentit të FSK-së në operacionet e përbashkëta në ushtrimin 'Reagimi i Menjëhershëm-16' në Slloveni- Kroaci







Forca e Sigurisë së Kosovës në kuadër të bashkëpunimit shumëpalësh gjatë vitit 2016, po zhvillon operacionet e përbashkëta në kuadër të ushtrimit ,,Reagimi i Menjëhershëm 16", në Slloveni-Kroaci, ku është përfaqësuar me një kontingjent prej 26 pjesëtarësh, të përbërë nga oficerë të personelit, CIMIC-it, mjekësisë, deminimit (EOD) dhe kërkim-shpëtimit. Kontingjenti i FSK-së, udhëhequr nga nënkolonel Fidaim Elshani-komandant i kontingjentit, ka marr pjesë në disa ushtrime të përbashkëta ndërkombëtare së bashku me vendet e NATO-s dhe vendet e rajonit, si: Anglia, Bosnja dhe Hercegovina, Hungaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, SHBA, Slloveni dhe Shqipëria.Kontingjenti i FSK-së ishte vendosur në tri lokacione: Novo Mesto, Cerklje dhe Zagreb, ku së bashku me vendet pjesëmarrëse angazhohen në reagime ndaj sfidave dhe situatave të krijuara. Nënkolonel Elshani na njoftoi më konkretisht rreth ecurisë së ushtrimit dhe qëllimit të tij. A ndër të tjera tha: "Qëllimi i këtij ushtrimi është i qartë dhe në kohezion me realitetin e krijuar, si kërcënimet e mundshme reale, përballja me kriza të refugjatëve dhe krijimi i forcës adekuate për reagim të menjëhershëm, duke promovuar stabilitet rajonal, forcim të kapaciteteve partnere dhe përmirësim të ndërveprimit të kapaciteteve të NATO-s dhe forcave të armatosura të vendeve anëtare të Partneritetit për Paqe (PFP)".FSK-ja në këtë ushtrim është përfshirë në të gjitha nivelet, duke filluar nga kontrolli i ushtrimit (HICON), oficeri ndërlidhës, Qendra operative e batalionit, Qendra operative taktike, qendrat e bashkëpunimit civilo-ushtarak, e deri tek intervenimet e përbashkëta për eliminimin e mjeteve të pashpërthyera(EOD-së), kërkim-shpëtimin në male, si dhe evakuim dhe trajtim mjekësor.Ushtrimi "Reagimi i Menjëhershëm 2016" (IR'16) ka filluar më 09 shtator dhe do të përfundojë më 22 shtator 2016.

Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli mori pjesë në ditët e vizitorëve të ushtrimit fushor 'Immediate Response -16' në Kroaci



Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli me ftesë të Ushtrisë së Republikës së Kroacisë dhe asaj të Sllovenisë, më 26 shtator 2016, mori pjesë në ditët e vizitorëve të ushtrimin fushor "Immediate Response 16" në Slunj të Republikës së Kroacisë dhe në Slloveni, për të përcjellë nga afër aktivitetet e këtij ushtrimi.Me këtë rast, gjeneral Hazrolli falënderoi përfaqësuesit e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës(SHBA), ato të Sllovenisë dhe të Kroacisë për ftesën e adresuar për pjesëmarrje të FSK-së në këtë ushtrim, duke kërkuar nga ta thellimin dhe avancimin e bashkëpunimit në të ardhmen.Në ditën e vizitorëve në Slloveni të pranishëm ishin edhe përfaqësues shtetërorë dhe ushtarakë si: kryeministri i Republikës së Kroacisë, deputetë të Parlamentit të Republikës së Sllovenisë, përfaqësues shtetërorë të akreditуar në Slloveni dhe Kroaci, ambasadori i Republikës së Kosovës në Slloveni, shefi i Shtabit të Ushtrisë Kroate, shefi i Shtabit të Ushtrisë Sllovene, Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, përfaqësues ushtarakë të Shteteve të Bashkuara dhe të tjerë. Ushtrimi fushor ndërkombëtar "Immediate Response 16"është organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë (USARUER), nga dt. 09-22.09.2016, në Republikën e Kroacisë dhe atë të Sllovenisë. Në këtë ushtrim FSK-ja është përfaqësuar me një kontingjent prej 26 pjesëtarësh të njësiteve të Kërkim Shpëtimit, Deminimit, Mjekësisë dhe Bashkëpunimit Ushtarako-Civil.Forcat tona kanë qenë të vendosura në dy shtetet pritëse, në Slloveni dhe Kroaci, përkatësisht në tri lokacione, Novo Mesto, Cerklje dhe Zagreb, ku së bashku me vendet pjesëmarrëse janë angazhuar në reagime ndaj sfidave dhe situatave të krijuara. FSK-ja pati paraqitje të shkëlqyeshme gjatë ushtrimit "Immediate Response 16" .

Ministri dhe komandanti i FSK-së, nderuan me medalje Atasheun amerikan të Mbrojtjes kolonelin Chad Buts



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), më 2 shtator, u mbajt ceremonia lamtumirëse për nderë të Atasheut të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës(SHBA), kolonelit Chad Butts, me rastin e përfundimit të misionit të tij, si Atashe i Mbrojtjes i akreditуar në Republikën e Kosovës. Në ceremoninë lamtumirëse morën pjesë; Ministri Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministrat Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralët; Zymer Halimi, Nazmi Brahimaj, Gëzim Hazrolli dhe Enver Cikaqi, atashetë ushtarak të akreditуar në Kosovë, ish Ministri i FSK-së, deputeti Agim Çeku dhe ish- komandanti i FSK-së, gjenerali në pension Kadri Kastrati, si dhe oficerë e zyrtarë tjerë të lartë të FSK-së dhe Ambasadës amerikane në Republikën e Kosovës.Me këtë rast, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, në emër të Ministrisë së FSK-së, falënderoi atasheun ushtarak të SHBA-ve, kolonelin Butts, për angazhimin dhe kontributin e tij dhënë për FSK-së, në ngritjen profesionale si dhe ndihma materiale. Ministri Demolli me rastin e kryerjes së misionit të tij në Kosovë, e dekoroi kolonelin Butts, me medaljen "Shërbim të Shquar" për kontributin në ngritje profesionale të FSK-së.Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, dhuroi kolonelit Butts, medaljen "Shërbim Vetëmohues" për përformancë të shkëlqyeshme gjatë kryerjes së detyrës ushtarake si Atashe i Mbrojtjes pranë ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, gjatë periudhës kohore 2014-2016, si dhe për mbështetje të jashtëzakonshme dhënë FSK-së.Atashe i mbrojtjes i SHBA-ve, në Kosovë, koloneli Butts, pasi pranoi medaljen tha se ky është një nder për mua, që më bënë ministri Demolli dhe gjeneral Rama, dhe është njëri prej shpërblimeve më të mira që kam marrë ndonjëherë. Koloneli Butts në fund tha se ndjehet krenar për punën dhe shërbimin në Kosovë dhe veçanërisht me bashkëpunimin me FSK.



Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama priti komandantin e parë të KFOR-it, gjeneralin Mike Jackson

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 20 shtator 2016,priti në takim gjeneralin anglez në pension Mike Jackson. Pas luftës gjenerali Jeckson ka qenë drejtpërdrejt i angazhuar në transformimin e UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), e po ashtu ka qenë edhe Komandanti i parë i KFOR-it në Kosovë, atëherë, kur janë vendosur bazat e bashkëpunimit mes KFOR-it dhe TMK-së. Gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, e falënderoi gjeneralin Jackson për gjithë atë që ka bërë për Kosovën, dhe përmes tij edhe Mbretërinë e Bashkuar për ndihmën e vazhdueshme që kanë dhënë dhe po japin në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së. Komandanti i FSK-së, e njoftoi gjeneralin Jackson edhe me të gjitha zhvillimet e deritashme në FSK, si; shkollimet, trajnimet, bashkëpunimin rajonal, pjesëmarrjen në trajnime rajonale dhe përgatitjet e përgjithshme rreth transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.Nga ana e tij, ish-komandanti i parë i NATO-s në Kosovë, gjenerali Jackson, e falënderoi komandantin e FSK-së për pritjen, si dhe shprehu admirimin e tij për zhvillimin dhe të arriturat e përgjithshme të FSK-së, sipas standardeve të shteteve anëtare të NATO-s.Në pritje të gjeneralit Jackson ishin edhe ambasadori i Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, z. Lirim Greiçevci, këshilltari i komandantit të FSK-së, kolonel Andy Lyton dhe majori Berat Shala.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama ndau mirënjohje për instruktorët amerikanë

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama,më 16 shtator 2016, priti një ekip të instruktorëve amerikanë-oficerë të Gardës Kombëtare të Ajovës, të udhëhequr nga rreshter majori Rick Noyes, ku ishte i pranishëm edhe drejtori i Departamentit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit të Ministrisë së FSK-së, z. Beqir Bytyçi. Trajnimi është zhvilluar në kuadër të Departamentit të SKI-së të Ministrisë për FSK-në, nga data 7-16 shtator 2016, dhe kishte për qëllim ofrimin e këshillave rreth sigurisë kibernetike, si përmirësimin e funksionimit të SKI-së dhe mbrojtjes kibernetike - analizën e sigurisë në rrjetet dhe pajisjet e FSK-së. Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në emër të FSK-së falënderoi instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës për kontributin e tyre të pakursyer dhënë MFSK-së dhe FSK-së, në kuadër të bashkëpunimit të mirë në mes FSK-së dhe Ushtrisë amerikane, e në veçanti Gardës Kombëtare të Ajovës. Ndërsa, nënoficeri Rick Noyes, udhëheqës i instruktorëve, e falënderoi komandantin e FSK-së për pritjen dhe njëherësh e njoftoi edhe me aktivitetet e përbashkëta që u zhvilluan gjatë trajnimit. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, për të gjithë instruktorët amerikanë ndau mirënjohje me motivacionin, "Për ekspertizë të shkëlqyer, komunikim dhe mbështetje në zhvillimin e FSK-së".



Gjenerali Dietmar Mosmann vizitoi Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Istog



Më 22 shtator 2016, në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) kolonel Xhevahir Geci, priti në një takim pune drejtorin e ri të NALT-it (Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO), gjeneral brigade Dietmar Mosmann, të shoqëruar nga nënkoloneli Mosabek- asistent ushtarak dhe këshilltarët e NALT-it për BRSh-në, majori Kuchta dhe majori Bruning. Gjatë këtij takimi, koloneli Geci e njoftoi drejtorin e NALT-it, për aktivitetet e përgjithshme të BRSh-së si dhe e falënderoi për bashkëpunimin e mirë që kanë pasur deri me tani, duke shpresuar që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe me tej. ,,Bashkëpunimi me ekipet për Këshillim të NATO-s gjithherë ka qenë i shkëlqyeshëm. Ne kemi qenë transparent, dhe së bashku jemi angazhuar që të zhvillojmë forcën tonë. Shpresoj që ky bashkëpunimi të thellohet edhe më shumë në të ardhmen".Ndërsa shefi i Operativës së BRSh-së, major Shiqer Maloku mbajti një takim të shkurtër informues, ku të pranishmit i njoftojë me misionin, strukturën, lokacionet, trajnimet, gjendjen e gatishmërisë, planifikimin dhe sfidat e Brigadës për Reagim të Shpejtë. Gjeneral brigade Dietman Mosmann së bashku me komandantin e BRSh-së dhe oficerë të lartë, përcollën nga afër aktivitetet të cilat u realizuan sipas planit të BRSh-së, si dhe disa demonstrime të shkurtra të pjesëtarëve në një situatë të improvizuar të Reagimit në pritë. Në fund, gjenerali Mosmann u nda mjaft i kënaqur, me c 'rast falënderoi të pranishmit për pritjen, dhe njëherësh përgëzoi kolonel Gecin për të arriturat e BRSh-së dhe performancën e pjesëtarëve të saj .

FSK-ja pjesë e kampit veror ndërkombëtar në Kroaci



Nga data 1 e deri më 9 shtator 2016, në bazën "Kovcanje" Loshinj të Vogël të Kroacisë, u mbajt kampi veror ndërkombëtar, në të cilin morën pjesë përfaqësues ushtarakë nga: Kroacia, Kosova, Shqipëria, Çekia, Maqedonia, Sllovenia, Komanda e Bashkuar e NATOS-s në Brunsum, Komanda e Bashkuar e NATO-s në Napoli, Garda Kombëtare e Minesotës, EUCOM-i dhe Aleanca e Bashkuar e Operacioneve të NATO-s.Rreshter majori i FSK-së Genc Metaj, i ftuar si mysafir nderi, mbajti një ligjëratë para të pranishmëve me temën "Lidershipi dhe sfidat e papritura", ndërsa kapteri Naim Smakolli ligjëroi temën: Të arriturat e FSK-së dhe zhvillimi i trupës së nënoficerëve. Pjesëmarrja e FSK-së, në këtë kamp, ishte një ngjarje shumë e rëndësishme për FSK-në, sepse krijoi mundësi për forcimin e raporteve me vendet partnere pjesëmarrëse, gjithashtu edhe ndikoi në zhvillimin profesional duke shkëmbyer përvojat më të mira dhe duke nxjerr mësime.

Në garën "Vrapo për të rënët" organizuar nga KFOR-i Amerikan, në Bonstel,

Gani Kryeziut i takoi vendi i parë



Gani Kryeziu pjesëtar i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK) i sistemuar në Batalionin e Parë të Reagimit të Shpejtë(BRSH) në Gjilan, më 26 shtator 2016, stoliset me medaljen e artë, pasi që zuri vendin e parë në vrapimin 5 kilometër, në kategorinë e meshkujve, në garën " Runfor the Fallen"(Vrapo për të rënët), organizuar nga KFOR-i, në kampin e KFOR-it "Bonsteel" në Sojevë, si shenjë nderimi për viktimat në shtetin e Pensilvani-së(SHBA).Në këtë garë të realizuar më 24 shtator 2016, për nder të viktimave të Pensilvanisë garuan rreth 150 pjesëtarë nga 8 shtete, me ç'rast u realizuan aktivitete të ndryshme, si marshimi "Pathto Honnor" 45 kilometra, marshimi "Iron Trail" 22.5 kilometra dhe vrapimi "Runfor the Fallen" në gjatësi prej 5 kilometra.FSK-ja, përkatësisht Batalioni i Parë i Reagimit të Shpejtë ka marrë pjesë në marshimin 22. 5 kilometra, me 15 pjesëtarë me ngarkesë dhe me pajisje individuale dhe në vrapimin prej 5 kilometrash me një pjesëtar.Pjesëtarët e Batalionit të Parë, gjithashtu, u stolisën edhe me medalje të bronztë, duke zënë vendin e tretë në marshimin "Iron Trail", medalje e cila iu nda rreshter Besim Behlulit.



Gjeneral brigade Enver Cikaqi në shënimin e 15-vjetorit të themelimit të KDS-së në Shqipëri

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, me ftesë të komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS) të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneral brigade Dedë Prenga, (09.09.2016) mori pjesë në shënimin e 15-vjetorit të themelimit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Tiranë.Ceremonia e themelimit të KDS-së, u mbajt në mjediset e auditorit të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipëri, në të cilën morën pjesë: ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral-major Jeronim Bazo, komandantët e Forcave, drejtorë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Forcave të Armatosura, atashe ushtarakë, drejtues institucionesh dhe repartesh të FA dhe ish - komandantë të KDS-së.Në fjalimet e tyre të mbajtura me këtë rast, ministrja Kodheli dhe komandant Prenga, ndër të tjera theksuan rëndësinë e këtij institucioni, arritjet dhe sfidat që i presin në vitet në vijim.Komandanti i KDS-së i FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, zhvilloi edhe një takim zyrtar me komandantin e KDS-së të FA të Shqipërisë, gjeneral brigade Dedë Prenga, me të cilin biseduan për thëllimin e bashkëpunimit të ndërsjellë mes dy njësive në të ardhmen.Në fund, për të pranishmit u shfaq një material i shkurtër filmik, i cili pasqyron punën 15-vjeçare të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, dhe më pas të gjithë pjesëmarrësit vizituan ekspozitën retrospektive të organizuar me këtë rast.

FOTOKOLAZH NGA AKTIVITET E FSK-së

















FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 52 • Nëntor 2016 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri Haki Demolli priti zv. asistentin për operacione të Sekretarit gjeneral të NATO-s, John Manza

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës(FSK), z. Haki Demolli, priti (6. 10. 2016) në një takim zëvendës asistentin për operacione të Sekretarit Gjeneral të NATO-s, z. John Manza, i cili shoqërohej nga drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe FSK-në(NALT), gjeneral brigade Dietmar Mosmann, zëvendës drejtori i ekipit të NALT-it, Dominic Braithwaite dhe bashkëpunëtorë të tjerë.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli e njoftoi delegacionin e NATO-s, për punën dhe angazhimin e shkëlqyer të NALT-it në MFSK dhe FSK.

Ministri Demolli, me këtë rast, tha se; këshillimi dhe koordinimi me mekanizmat e NATO-s na ndihmon dhe lehtëson zhvillimin, avancimin e FSK-së me standarde që do të mundësojnë ndërvepruesmëri si dhe do të përgatis institucionet tona të sigurisë për anëtarësim në mekanizma; iniciativa rajonale dhe globale, dhe përfundimisht në Aleancën Veri-Atlantike, synim ky shumë i vendosur i Republikës së Kosovës.

Ndërsa për procesin e transformimit të FSK-së, në Forca të Armatosura të Kosovës, ministri Demolli, tha: "në vazhdimësi i kemi njoftuar të gjithë akterët, i kemi caktuar elementet kryesore të transformimit, fazat si dhe kemi përgatitur amendamentet dhe pakon e ligjeve", dhe i tërë procesi, do të jetë transparent për institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, duke garantuar që Kosova është e vendosur në ndërtimin e një Force, që do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës, si dhe Forcë, që do të kontribuojë për paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë.

Për sukseset e përgjithshme të FSK-së; trajnimet, ushtrimet e përbashkëta ndërkombëtare, si



dhe ftesat që Kosova ka marrë, për të marrë pjesë në ushtrimet e deritanishmeve edhe në ushtrimet ndërkombëtare, delegacionin e NATO-s, e njoftoi gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione.

Nga ana e tij, zëvendës asistenti për Operacione i Sekretarit gjeneral të NATO-s, zoti John Manza përgëzoi ministrin Demolli, për të arriturat si dhe zhvillimin e FSK-së. Ai konfirmoj se NATO, me vëmendje po përcjell zhvillimin e FSK-së, sektorin e Sigurisë, dhe gjithashtu është duke shqyrtuar letrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ku së shpejti do të del me një përgjigje. Kurse, sa i përket pjesëmarrjes së FSK-së, në ushtrimet fushore të përbashkëta ndërkombëtare, si dhe shkollimeve dhe trajnimeve, z. Manza, tha se; strategjia juaj që përmes pjesëmarrjes në operacione stërvitore të përbashkëta, si në Kosovë, ashtu edhe në vendet partnere, është strategji shumë e mirë, dhe garantoj në mbështetjen e strategjisë së FSK-së, që përmes stërvitjeve të përbashkëta me vendet e NATO-s, vendet partnere të dëshmojë për aftësitë e saja ndërvepruese.

FSK-ja fitoi medaljen e artë në ushtrimin “Cambrian Patrol 2016” në Britani të Madhe



Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), prej 13 pjesëtarësh të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), mori pjesë në një gare të madhe ushtarake, e cila u zhvillua në Wells të Mbretërisë së Bashkuar.

Skuadra e BRSH-së të FSK-së, është dekoruar me Medaljen e artë, në një ndër ushtrimet më sfiduese dhe më prestigjioze në botë.

Ceremoninë e dekorimit me medaljen e artë nga afër e ka ndjekur edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama i cili duke parë nivelin e sfidave gjatë këtij ushtrimi është ndarë jashtëzakonisht i kënaqur me performancën e skuadrës.

Gjatë zhvillimit të patrullës skuadra e FSK-së edhe pse pjesëmarrëse për herë të parë ka treguar një profesionalizëm të jashtëzakonshëm duke arritur të njëjtin nivel me njësitë me elite të ushtrive më të zhvilluara në botë.

Në këtë ushtrim përveç 102 skuadrave nga njësi të ndryshme të ushtrisë britanike kanë marrë pjesë gjithsejtë edhe 18 skuadra mysafire, përfshirë ushtritë nga vendet si Gjermania, Italia, Zvicrra, Kanada, Pakistani, Nepali, Brazili, Kili, Bosnia dhe Hercegovina, Irlanda, India, Belgjika, Çekia, Australia, Zelanda e Re, Gjeorgjia, Meksika, dhe Latvia.

Deri në fazën e 6-të vetëm 10 skuadra përfshirë skuadrën e FSK-së kanë arritur të dekorohen me medaljen e artë, shumë të tjera kanë arritur vetëm ta përfundojnë ose kanë marrë medaljen e argjendtë dhe bronzi, ndërsa 16 të tjera për arsye shëndetësore apo në mungesë të përgatitjeve të mjaftueshme janë tërhequr nga ushtrimi.

Ky ushtrim daton qysh nga viti 1959 dhe njihet në mbarë botën si një ndër patrullat më të vështira, ku një numër i vogël skuadrash arrijnë të dekorohen me medaljen e artë por edhe shkalla e dështimit është mjaftë e lartë. Me qenë se kjo është hera e parë që Kosova merr pjesë në këtë lloj ushtrimi, dekorimi me medaljen e artë i ka lënë të befasuar si vendin nikoqir ashtu edhe vendet tjera pjesëmarrëse.

Kjo performancë e suksesshme e skuadrës ka bërë që FSK të njihet nga vendet pjesëmarrëse si një organizatë serioze dhe shumë profesionale, ku pa dyshim që në të ardhmen si rezultat pritet të rrisë bashkëpunimin me ushtritë e vendeve të tjera. Ky sukses ka qenë një tjetër dëshmi që FSK po shkon në hapa të sigurt drejt zhvillimit të një force profesionale duke nxjerrë kuadro të rinjtë që në evenimente të ndryshme janë konkurrencë serioze për ushtritë e vendeve të zhvilluara.

U mbajt konferenca e 5-të ‘FSK dhe Partnerët’

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 28 tetor 2016, u mbajt konferenca e dytë vjetore "FSK dhe partnerët" nën organizimin e Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri të MFSK-së dhe me pjesëmarrjen e atasheve të Mbrojtjes të akreditauar në vendin tonë, e ku ishin të pranishëm edhe ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zv.komandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Riener, gjeneral Steven Altman nga Garda Kombëtare e Ajovës, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s, gjeneral Dietmar Mosmman si dhe diplomatë dhe përfaqësues institucionalë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në fjalën e hapjes, ministri i FSK-së Haki Demolli tha se Ministria e Forcës së Sigurisë, respektivisht FSK-ja, objektiv primar kanë intensifikimin e bashkëpunimit me partnerët, ku përmes të cilit shtetet mike të Republikës së Kosovës po ofrojnë mbështetje në forma të ndryshme në ngritjen e kapaciteteve tona.

Gjithashtu, ministri Demolli tha se takimet e këtilla, si kjo konferencë apo ushtrimet e përbashkëta siç ishte ushtrimi i djeshëm fushor "Shqiponja V", ku pjesëmarrës të planifikimit dhe realizimit të tij ishin edhe ushtarët dhe oficerët e Ushtrisë Amerikane dhe pjesëtarët e KFOR-it, ndërsa shumë ushtarakë të shteteve mike ishin në cilësinë e vëzhguesve, po ndikojnë jo vetëm në rritjen e ndërveprimit ndërmjet nesh, por edhe në rritjen e mundësive për zhvillimin e trajnimeve të mirëfillta në përputhje me standardet veri-atlantike, e të cilat janë synim final i FSK-së dhe Republikës së Kosovës në tërësi.

Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se, FSK-ja që nga themelimi i saj është përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve të veta, si në personel ashtu edhe në infrastrukturë, në pajisje dhe në krijimin e kushteve sa më të mira për pjesëtarët tanë.

(Vijon në faqen 2)



U mbajt konferenca e 5-të 'FSK dhe Partnerët'

(Vijon nga faqja 1)

Më tej, gjeneral Rama, duke iu drejtuar mysafirëve, tha se: "Ju keni një rol kyç në këtë drejtim, sepse gjithçka që kemi bërë deri tani ishte në partneritet me ju dhe bazuar në standardet e NATO-s". Prandaj, tha komandanti i FSK-së "vazhdimi i këtij bashkëpunimi të shkëlqyeshëm është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të FSK-së, si një institucion për të mirën e vendit dhe kontribuuese e sigurisë".

Me nga një fjalë rasti në konferencë u paraqitën edhe zv. komandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Riener, gjenerali nga Garda Kombëtare e Ajovës, Steven Altman dhe gjeneral Mosmman, drejtor i NLAT-it.

Punimet e konferencës "FSK dhe partnerët" i kryesoi, kolonel Ilir Qeriqi, ndërsa drejtorët, shefat dhe oficerët e departamenteve të Personalit, Financave, Operacioneve dhe Trajnimeve, Logjistikës, Mjekësisë, Planeve dhe Politikave, Sigurisë dhe Inteligjencës, Qendrës së Trajnimit të Kërkim-Shpëtimit, Komunikimit dhe Sistemeve të Informimit etj., prezantuan objektivat e zhvillimit si dhe paraqiten sfidat dhe nevojat për të ardhmen.

Gjithashtu edhe atashetë e Mbrojtjes të vendeve partnere si ShBA, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Shqipëria, Kroacia, Hungaria, Italia, Gjermania, Holanda, Maqedonia dhe Japonia prezantuan kapacitetet dhe ofertat për mbështetje në fushat me interes për FSK-së për periudhën e ardhshme, si dhe diskutuan për aktivitetet në kuadër të planeve të bashkëpunimit dypalësh në të ardhmen.

Qëllimi i konferencës ishte rritja e ndërsjellë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes FSK-së dhe vendeve partnere, e po ashtu edhe Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATOS për MFSK-në dhe FSK-në(NALT) si organizëm mbështetës i FSK-së, e në të njëjtën kohë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës nga fusha e sigurisë dhe diplomacisë, më qëllim të qasjes gjithëpërfshirëse të institucioneve relevante për sinkronizimin dhe ndërveprimin në mes institucioneve tona në të mirë të zhvillimit të kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Diplomatë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë u pritën nga ministri i FSK-së, Haki Demolli

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli, më 26 tetor 2016, priti në takim zyrtar një delegacion nga ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë në përbërje; Dastid Koreshi, drejtor i Drejtorisë për Politika të Sigurisë, z. Plator Kalakula, përgjegjës i Sektorit të NATO-s, të shoqëruar edhe nga ambasadori shqiptarë në Republikën e Kosovës, z. Qemal Minxhozi.

Në takimin e ministrit Demolli me diplomatët shqiptar bisedoi lidhur me bashkëpunimin e dy shteteve në fushën e sigurisë, diplomacisë si dhe koordinimin për gjetjen e rrugëve të mundshme për të forcuar bashkëpunimin me NATO-n.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli tha se duke qenë se FSK-ja është ngritur dhe po zhvillohet me standarde të NATO-s, dhe se aspirata e Kosovës është anëtarësimi në NATO, për Kosovën rruga e zhvillimit dhe anëtarësimit në NATO e Republikës së Shqipërisë është model.

Nga ana e tyre diplomatë shqiptar nga ministria për Punë të Jashtme shprehën gatishmërinë që të koordinohen me shtetin e Kosovës dhe institucionet e saj në mënyrë që Kosova të ecë me hapa të shpejt dhe të sigurt drejt anëtarësimit të saj në mekanizmat e sigurisë në rajon, Evropë dhe me gjerë, si dhe në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Ministri Haki Demolli takoi delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli i shoqëruar edhe nga shefi i Inspektoratit të FSK-së, gjeneral brigade Bashkim Jashari, (20 tetor 2016) pritën në takim zyrtar një delegacion të Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, kryesuar nga gjeneral brigade Blazh Beretin, zëvendësshef i Inspektoratit të Mbrojtjes me bashkëpunëtorë dhe në shoqërim të ambasadores kroate në Prishtinë, Marija Kapitanovici.



Me këtë rast, ministri Demolli theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh dhe miqësor në mes Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe bashkëpunimin me Ambasadën e Republikës së Kroacisë në Prishtinë.

Ministri Demolli gjithashtu, theksoi se bashkëpunimi dypalësh me Kroacinë në fushën e sigurisë ka qenë jashtëzakonisht produktiv, dhe se shteti kroat dhe Ministria e Mbrojtjes së Kroacisë kanë dëshmuar se mbështesin plotësisht përpjekjet e shtetit të Kosovës për konsolidimin dhe avancimin e institucioneve të sigurisë të vendit tonë.

Në fund të fjalës së vet, ministri Haki Demolli i falënderoi ambasadoren Kapitanovic dhe gjeneralin Beretin për vizitën dhe gatishmërinë e tyre për shkëmbim përvojash në fushën e inspektoratit, si dhe për mbështetjen që vendi i tyre ka ofruar në vazhdimësi për FSK-në dhe angazhimet tona rajonale dhe ndërkombëtare.

Nga ana e saj, ambasadorja e Kroacisë zonja Kapitanovic tha se shteti i Kroacisë dhe shteti i Kosovës po zhvillojnë dhe ndërtojnë marrëdhënie të shkëlqyera dhe se marrëdhëniet më intensive i ka pikërisht në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Ambasadorja tha gjithashtu se vendi i saj ka kaluar nëpër të njëjtat vështirësi dhe situata si dhe ka kaluar të njëjtën përvojë dhe për këtë Kapitanovic tha se vendi i saj është angazhuar dhe do të angazhohet që shteti i Kosovës të mos ketë pengesa të natyrës që Kroacia i ka kaluar më parë.

Ambasadorja Kapitanovic në fund tha se Kroacia ofron përkrahje të vazhdueshme si rreth anëtarësimit në NATO ashtu edhe integrimit në Bashkimin Evropian, me një fjalë ambasadorja tha se "Jemi zëri juaj më i fuqishëm në Bruksel".

Shefi i Inspektoratit të FSK-së, gjeneral brigade Bashkim Jashari, priti në takim gjeneral brigade Blazho Beretin, zëvendës shef i Inspektoratit të Mbrojtjes të Kroacisë

Gjeneral brigade Bashkim Jashari, shef i Inspektoratit të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), në MFSK, priti në vizitë zyrtare një delegacion nga Ministria e Mbrojtjes të Kroacisë kryesuar nga zëvendësshefi i Inspektoratit të Mbrojtjes të Kroacisë, gjeneral brigade Blazh Beretin nën shoqërimin e ambasadores së Kroacisë në Prishtinë, zonjës Maria Kapitanovic.

Fillimisht, të dyja delegacionet zhvilluan një takim të përbashkët ku u diskutua për bashkëpunimin e mirë, aktivitetet e përbashkëta për shkëmbimin e përvojave në fushën e inspektoratit si dhe vizitat dhe shkëmbimet e ndërsjella ndërmjet dy ministrive në këtë fushë.



Nga ana e tij, gjeneral Jashari falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes të Kroacisë e posaçërisht Inspektoratin e Mbrojtjes të Kroacisë për ofrimin e mundësisë për shkëmbim përvojash dhe mbështetje për zhvillimin e këtij sektori në MFSK.

Ambasadorja kroate, Kapitanovic e gjithashtu edhe gjenerali Beretin shprehën gatishmërinë për vazhdimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive dhe dy sektorëve, të dy vendeve tona mike siç u shprehën ata.

Më tej, të dy delegacionet zhvilluan një takim të zgjeruar ku prezantuan secili për ministrinë përkatëse, misionin, strukturën, detyrat, dhe obligimet i këtij sektori, si dhe diskutuan për mënyrat dhe metodat më të avancuara për funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes në Kroaci dhe Inspektoratit të FSK-së në Kosovë.

Delegacioni kroat i ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë në krye me gjeneral brigade Blazh Beretin dhe në përbërje: kolonel Mladen Prebezec, inspektor për plane dhe politika të mbrojtjes, kolonel Miriam Antolic, shefe e Sektorit për burime njerëzore në Inspektoratin e Mbrojtjes si dhe kolonel Ivica Mateshic, atashe ushtarak i Kroacisë i akreditуar për Kosovë me rastin e vizitës në Kosovë, dje fillimisht kanë vizituar Prekazin dhe memorialin përkujtimor, , Adem Jashari" ku kanë bërë homazhe duke vendosur edhe kurorë lulesh të freskëta, në shenjë nderimi të sakrificës dhe luftës për liri të Komandantit legjendar dhe popullit shqiptar të Kosovës në përgjithësi.



Ministri Haki Demolli takoi ambasadorin e Italisë, Piero Sardin

Ministri i ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(FSK), z. Haki Demolli, më 3 tetor 2016, priti në takim ambasadorin e Republikës së Italisë në Republikën e Kosovës, zotëri Piero Cristoforo Sardi, i shoqëruar nga atasheu i Mbrojtjes i akreditуar për Kosovë, kolonel Franco Galletti.



Në takimin e përbashkët të ministrit Demolli dhe ambasadorit Sardi, u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Italisë, për fushat e bashkëpunimit, për identifikimin dhe konkretizimin e aktiviteteve si dhe vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

Ministri Demolli, duke i uruar ambasadorit italian detyrën e re, i shprehu edhe besimin se bashkëpunimi me Ambasadën italiane do të vazhdojë dhe do të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen, dhe përmes saj edhe me shtetin, qeverinë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Italisë.

Ministri Haki Demolli, u shpreh se ashtu si deri më tani edhe në të ardhmen, pret që shteti i Italisë të bëjë hapa përpara në drejtim të arritjes së marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e sigurisë ndërmjet dy vendeve, e gjithashtu edhe mbështetje për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura.

Nga ana e tij, ambasadori i Italisë, zotëri Sardi u shpreh se Italia vazhdon ta sheh Republikën e Kosovës si faktor stabiliteti në regjion dhe se është e interesuar që ta mbështes në rrugën e saj të zhvillimit

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjenerallejtënant Rrahman Rama pjesë e konferencës ushtarake në SHBA



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, nga data 1 e deri më 5 tetor 2016, mori pjesë në konferencën vjetore të Shoqatës të Ushtrisë Amerikane, e cila u mbajt në Ëashington të ShBA-së.
Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama gjatë vizitës në ShBA është pritur nga komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majori Thimoty Orr, me të cilin kanë biseduar rreth vazhdimit të bashkëpunimit të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës e gjithashtu edhe me personalitete të larta ushtarake pjesëmarrëse në konferencë si dhe vizitoj edhe panairin e armëve dhe sistemeve mbrojtëse.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, priti komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës (SHBA), gjeneral Timothy Orrin



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli (19. 10. 2016) priti në një takim zyrtar komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës(SHBA), gjeneral Timothy Orr, i cili qëndroi për vizitë zyrtare në Kosovë. Në takimin e ministri Demolli dhe gjeneralit Orr, e ku ishin të pranishëm edhe gjeneralët Zymer Halimi dhe Gëzim Hazrolli, u bisedua për marrëdhëniet e partneritetit mes dy institucioneve, shkallën e bashkëpunimit, aktivitetet në vazhdim, si dhe për perspektiven e ngritjes dhe intensifikimin e nivelit të këtij bashkëpunimi në kuadër të partneritetit shtetëror Kosovë-Ajovë. Ministri Demolli me këtë rast, falënderoi gjeneralin Orr, për mbështetjen dhe përkrahjen që Garda Kombëtare e Ajovës ka ofruar për FSK-në, duke potencuar faktin se roli i SHBA-ve, si partner strategjik i Kosovës, është shumë i rëndësishëm për proceset që po kalon dhe përpjekjet që po bën vendi ynë për ndërtimin dhe funksionalizimin e institucioneve të sigurisë. Ministri Demolli, tha gjithashtu se Ministria për FSK dhe FSK-ja çmojnë lartë angazhimin e burrave dhe grave, ushtarakë amerikanë, të cilët për gjatë gjithë vitit kanë kontribuuar në avancimin e profesionalizmit të pjesëtarëve dhe njësive tona, në veçanti angazhimin e ushtarakëve amerikanë të cilët janë të angazhuar në planifikimin e stërvitjes së përgjithshme fushor të FSK-së "Shqiponja 5". Kurse gjenerali Orr i shoqëruar nga gjeneralët Zymer Halimi dhe Gëzim Hazrolli, u pritën në takim edhe nga sekretari i përgjithshëm i MFSK, Shkelzen Sylaj. Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral Timothy Orr u shpreh i lumtur me të arriturat e FSK-së, si dhe shprehu gatishmërinë e Ajovës dhe SHBA-së për vazhdimin e bashkëpunimit dhe përkrahjes.

Ministri Haki Demolli takoi ambasadorin e ri të Francës, Didier Chabertin



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli (21. 10. 2016) priti në një takim ambasadorin e ri në detyrë të Republikës së Francës në Republikën e Kosovës, z. Didier Chabert. Fillimisht, ministri Demolli i dëshiroi punë të mbarë dhe mision të suksesshëm ambasadorit francez në Republikën e Kosovës, dhe më pas i shprehu falënderimin e tij për bashkëpunimin e mirë me Ambasadën e Francës, duke çmuar lart kontributin e kontingjentit të Francës në kuadër të KFOR-it dhe gjithë interesimin dhe angazhimin që ka treguar Franca si njëra ndër shtetet e para që njohu pavarësinë e vendit tonë. Ministri Demolli, duke vlerësuar rolin dhe ndikimin e shtetit të Francës në rrjedhat e përgjithshme politike, ushtarake dhe të sigurisë në Evropë tha se, mbështetja dhe përkrahja e Francës për Kosovën në drejtim të ndërtimit dhe funksionalizimit të sektorit të sigurisë, me theks të veçantë transformimi i FSK në Forca të Armatosura të Kosovës, është më se i nevojshëm nëpërmjet mekanizmave të fuqishëm që posedon Franca aktualisht kudo në organizatat me peshë të organizimit evropian e më gjerë. Në fund, ministri Demolli gjithashtu i shprehu ambasadorit francez interesimin e Kosovës dhe MFSK-së që të iniciohet dhe zhvillohet procesi për formatizimin e bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Francës me Memorandum Bashkëpunimi, sikurse që MFSK-ja e ka aktualisht me 12 shtete anëtare të NATO-s dhe vende tjera, siç janë Britania e Madhe, Ajova(SHBA), Gjermania, Hungaria, Kroacia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi etj. Nga ana e tij, ambasadori i Francës në Prishtinë, z. Didier Chabert u shpreh jashtëzakonisht i interesuar për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit, si dhe për përkrahjen e tij në aktivitetet dhe planet në të ardhmen. Ai tha se ashtu siç e kemi njohur pavarësinë e Kosovës, si një ndër shtetet e para, ashtu do të vazhdojmë ta mbështesim edhe në zhvillimin e saj demokratik e të qëndrueshëm. Kjo është vizita e parë që z. Didier Chabert, ambasador i Francës, zhvillon në detyrën e shefit të misionit diplomatik.



Oficerë të Lartë të Shqipërisë vizituan Ministrinë për FSK-në

Një delegacion i oficerëve të Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM) të Akademisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, më 11 tetor 2016, vizituan Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë të Kosovës.
Oficerët e lartë nga Shqipëria i priti drejtori i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi me bashkëpunëtorë.
Gjenerali Zymer Halimi, me këtë rast, oficerët e lartë i njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së; me theks të veçantë për bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtarë; duke theksuar bashkëpunimin e mirë me NATO-n, dhe partneritetin me Gardën Kombëtare të Ajovës.
Kurse, drejtori i Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim (DTMS), nënkolonel Agron Bajrami përmes një prezantimi të shkurtër i njoftoi oficerët e lartë nga Shqipëria për FSK-në; dhe perspektivën e saj duke u fokusuar në "misionin dhe detyrat e FSK-së, ministrinë e integruar, strukturën e FSK-së, edukimin dhe trajnimet, më fokus të veçantë operacionet dhe partnerët ndërkombëtar" si dhe për ndryshimin e misionit dhe strukturës nga FSK në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK).
Në fund, shumë nga oficerë shfaqen interesim e tyre, përmes pyetjeve; për transformimin e FSK-së, bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtarë; bashkëpunimin me NATO-n, mekanizmat e saj, të vendosura në MFSK dhe në FSK; siç janë: NAT-i dhe NLAT-i, (Ekipet Këshilluese dhe Ndërlidhëse të NATO-s për FSK-në) etj.
Delegacioni i oficerëve i Kursit të Lartë nga Shqipëria vizitoi edhe kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore, ku u pritën nga zv. komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli i cili, delegacion e oficerëve të kursit të lartë nga Shqipëria e njoftoi me të arriturat e përgjithshme të Komandës së Forcave Tokësore dhe të njësive tjera të FSK-së.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli takoi ambasadorin e Hungarisë, Laszlo Markuszin



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli (18. 10. 2016) priti në një takim zyrtar ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, z. Laszlo Markusz. Ministri Demolli me këtë rast falënderoi ambasadorin Markusz për mbështetjen dhe përkrahjen që Hungaria ka ofruar për FSK-në, duke potencuar në veçanti edhe rolin e ambasadorit Markusz në realizimin e marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet Kosovës dhe Hungarisë në fushën e sigurisë. Ministri Demolli po ashtu shprehu dëshirën për të rritur bashkëpunimin në mes dy shteteve dhe dy ministrive përkatëse, duke e vlerësuar si shumë të rëndësishëm angazhimin dhe rolin e Hungarisë në mbështetje të agjendës sonë në Evropë. Nga ana e tij, ambasadori i Hungarisë në Prishtinë, z. Laszlo Markusz, falënderoi ministrin Demolli për pritjen dhe vlerësoi lart bashkëpunimin e ndërsjellë, duke u shprehur mjaft i kënaqur për thellimin e këtij bashkëpunimi. Ministri Demolli dhe ambasadori Markusz gjithashtu biseduan edhe për klimën e përgjithshme politike dhe të sigurisë në dy vendet tona, si dhe për klimën politike në rajon dhe më gjerë.

FSK-ja zhvilloi me sukses ushtrimin fushor 'Shqiponja 5'



Ushtrimi fushor "Shqiponja 5" është realizuar në bazë të Planit vjetor të trajnimeve për vitin 2016, udhëzimeve të komandantit të FSK-së për grupin punues dhe direktivave të NATO-s për ushtrime dhe trajnime kolektive. Skenar i ushtrimit fushor ka qenë kriza me refugjatë, dhe është zhvilluar në territorin e komunës së Hanit të Elezit, Malishevës dhe Prizrenit.

Në ushtrim kanë marrë pjesë gjithsej 652 pjesëtarë me 111 automjete, dhe janë realizuar mbi 30 operacione humanitare të sigurisë.

Në Ditën e vizitorëve (27. 10. 2016) të ushtrimit fushor të FSK-së, , Shqiponja 5", morën pjesë: ministri i FSK-së, Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Giovani Fungo, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Dietmar Mosmman, deputetët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, kryetarët e komunave, komandantët e kontingjenteve të KFOR-it, ambasadorë dhe atashe të akreditуar në Kosovë si dhe mysafirë të tjerë të ftuar, të cilët nga afër përcollën operacionet e njësiteve të FSK-së, Gardës Kombëtare të Ajovës, Ushtrisë Amerikane për Evropë, Policisë së Kosovës si dhe organizatave tjera emergjente të Kosovës.

Në Qendrën Operative të kampit fushor, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, njëherësh edhe drejtor i ushtrimit, kolonel Naim Haziri dhekomandanti i kampit nënkolonel Mehmet Lladrovci i njoftuan vizitorët e lartë dhe të pranishmit për procesin dhe fazat e planifikimit, organizimit dhe zhvillimit të ushtrimit fushor sipas skenarit të paracaktuar.

Me këtë rast, udhëheqësit e FSK-së, Gardës Kombëtare të Ajovës, KFOR-it etj., përcollën nga afër demonstrimet e njësive të specializuara të FSK-së, në vend-incidente si intervenimin kriminal "Pandora" si dhe vizitën në Kampin e refugjatëve.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, në fjalën e tij para mediave dhe pjesëmarrësve të ushtrimit ka përgëzuar FSK-në, oficerët e Gardës Kombëtare të Ajovës, Ushtrinë Amerikane për Evropë, KFOR-in, Policinë e Kosovës dhe agjencitë tjera të Kosovës për zhvillimin me sukses të ushtrimit fushor Shqiponja 5.

Ministri Demolli u nda i kënaqur me profesionalizimin e treguar në këtë ushtrim të FSK-së, ku me këtë rast përgëzoi komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramën për suksesin e FSK-së të treguar gjatë realizimit të ushtrimit të saj më të madh deri më tani.

Ministri Haki Demolli, gjatë zore dhe ushtarake të FSK-së, si dhe kapacitete teknike, për sfidat e ndryshme qoftë ato të karakterit humanitar, qoftë të karakterit të sigurisë.

Ky demonstrim i kapaciteteve të FSK-së është zhvilluar në pranině dhe vëzhgimin e vëzhguesve ushtarakë të vendeve mike që kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit. Kemi pas vëzhgues ushtarakë nga Shqipëria, Maqedonia, Kroacia dhe Sllovenia.

Nga ajo që pamë, mund të themi lirisht se FSK-ja është e gatshme për t'i kryer funksionet dhe aktivitet e parapara sipas mandateve kushtetuese dhe ligjore të FSK-së, që do të thotë se FSK-ja është e gatshme ta ndërrojë mandatin dhe misionin e vet dhe të transformohet në transformim të FSK-së në FA".

Amendamentet kushtetuese dhe draft ligjin për transformimin e FSK-së në FA i kemi proceduar te organet kompetente, përkatësisht te Qeveria e Kosovës, dhe varet nga zhvillimet politike se kur kryesia e Kuvendit do të vlerësojë kohën e duhur dhe sigurisht se do t'i procedojë më tutje. Por ajo çka dua të them është se ne si FSK dhe Ministri e FSK-së jemi të gatshëm në çdo kohë të transformohemi në FA".

Kurse komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama u shpreh tejet i kënaqur me demonstrimet gjatë ushtrimit të sotëm. Ai pos tjerash tha se, , Operacionet dhe aktivitetet e ushtrimit, , Shqiponja 5" të cilat i përcolln dërkombëtare. Testimi i suksesshëm i njësive dhe suksesi i arritur dëshmon që FSK-ja është e gatshme për detyra dhe përgjegjësi të reja". Objektiv i ushtrimit fushor, , Shqiponja 5" ishte trajnimi i liderëve dhe njësive për detyrat kolektive, me qëllim të realizimit të operacioneve komplekse në mbështetje të autoriteteve civile në fazën e planifikimit, ekzekutimit si dhe atë të analizimit, mbajtja e nivelit të gatishmërisë operative, zhvillimi i aftësive ekzistuese, përmirësimi i koordinimit me institucionet e tjera të sigurisë në operacion, dislokimi i forcave nga vend-bazimi i përhershëm në zonën e operacionit dhe zbatimi i sistemit të mësimeve të mësuara.





e njësisë së kërkim-shpëtimit të refugjatëve në lumin Drini i Bardhë, menaxhimin e hyrjes së refugjatëve në pikën kufitare, intervenimin e njësisë së Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH), në zonën kufitare për të eliminuar elementet e grupit fjalë së tij, nënvizoi qëllimin e mbajtjes së këtij ushtrimi fushor duke thënë se, "Ushtrimi kishte për qëllim që të testohen respektivisht të demonstrohen, dëshmohen dhe verifikohen në radhë të parë kapacitetet njerëzore të Armatosura të Kosovës. Në pyetjen e gazetarëve se kur pritet të bëhet transformimi i FSK-së në ushtri? Ministri Haki Demolli u përgjigj: " Ne si Ministri dhe FSK i kemi bërë të gjitha përgatitjet e duhura për lëm sot janë dëshmi që FSK-ja ka kapacitete për kryerjen e detyrave që aktualisht i ka të përcaktuara me mision. Ushtrimi ka dëshmuar se jemi të aftë për ndërveprime me institucione vendore dhe

Ministri i FSK-së Haki Demolli vizitoi ushtrimin fushor "Shqiponja 5"

Në orët e vona të pas ditës të së martës (25. 10. 2016), ministri i FSK-së, z. Haki Demolli i shoqëruar nga zëvendësministri Muhamet Latifi, sekretari i Përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj dhe gjeneral brigade Zymer Halimi drejtor i Drejtorisë së Operacioneve në MFSK, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli ushtrues detyre i komandantit të Komandës së Forcës Tokësore të FSK-së, dhe bashkëpunëtorë të tjerë, vizituan kampin e FSK-së në fshatin Nashec të Prizrenit.

Në fillim ministri Demolli është njoftuar nga komandanti i kampit nënkolonel Mehmet Lladrovci, me skenarin e ushtrimit fushor.

Kurse komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë kolonel Xhevahir Geci e ka njoftuar ministrin dhe bashkëpunëtorët me ecurinë e zhvillimit të ushtrimit fushor, motivin dhe angazhimin e ushtarëve për të realizuar objektivat e stërvitjes si dhe kushtet e vendosjes dhe akomodimit.

Ministri Demolli i ka përgëzuar ushtarët, oficerët e FSK-së për angazhimin e madh në realizimin e detyrave gjatë ushtrimit fushor, po ashtu ai posaçërisht ka falënderuar edhe ushtarët e SHBA-së, për Evropë dhe pjesëtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës, për kontributin e tyre në përgatitjen, por edhe bashkëpjesëmarrjen praktike në këtë ushtrim duke ngritur nivelin e rezultateve të stërvitjeve dhe ushtrimit fushor "Shqiponja -5".

Në kuadër të thellimit të bashkëpunimit në mes FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, në këtë ushtrim fushor për herë të parë janë pjesëmarrës aktiv kudo nëpër njësi, krah për krahë me ushtarët dhe oficerët e FSK-së edhe ushtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës nga SHBA-ja.

Po ashtu më këtë rast, ministri Demolli duke numëruar sukseset e FSK-së, falënderoi dhe uroi të gjithë pjesëtarët e FSK-së edhe për rezultatin në stërvitjen "Cambrian Patrol" të mbajtur në Vells të Mbretërisë së Bashkuar, ku togu i FSK-së, u nderua me medalje të artë, duke na bërë që të ndihemi krenar.

Ministri Demolli ka bashkëbisedуar me ushtarë dhe oficerë për rrjedhat e ushtrimit, vështirësitë dhe kushtet e përgjithshme të qëndrimit në natyrë. Po ashtu Ministri së bashku me ushtarë dhe eprorë të FSK-së, kanë darkuar në kuzhinën fushore të kampit.









Në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë diplomojnë kadetë të FSK-së nga komuniteti serb dhe boshnjak





Në Akademinë ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostollski" të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, diplomuan 36 studentë-kadetë të rinj, në mesin e tyre edhe katër kadetë të FSK-së, nga Kosova si dhe të tjerë nga Maqedonia, Bosnja Hercegovina dhe Mali i Zi.

Në ceremoninë e diplomimit të kadetëve morën pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së, znj. Azemina Qullum, shefe e Zyrës për Komunitete, Ibrahim Shala, drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun dhe kolonel Hasan Hoxha si dhe ministri i Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë, z. Zoran Jolevski, komandanti i Akademisë Ushtarake kolonel Orce Popovski, si dhe oficerë dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë, atashe ushtarak, familjarë të kadetëve, etj.

Në emër të Ministrisë së FSK-së, znj. Azemina Qullum, shefe e Zyrës për Komunitete, falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë për ndihmën e vazhdueshme në shkollimin e kadetëve të FSK-së. Ajo pos tjerash, tha: "Duke ju falënderuar marrëveshjes për bashkëpunim bilateral në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë të vitit 2012, është afruar mundësia për pjesëtarët e FSK-së, pjesëtarë të komunitetit serb dhe boshnjak që të shkollohen në nivel të lartë në Akademinë tuaj Ushtarake pa barriera gjuhësore të fitojnë dije, dhe përvojë profesionale nga kolegët maqedonas dhe atë ta bartin në vendin e tyre, e krejt kjo me qëllim të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në regjion. Më tej, z. Qullum, vazhdoi: ",..., veçanërisht është e rëndësishme të theksoj se këta janë oficerët e parë nga radhët e komuniteteve pakicë të Kosovës, të cilët të shkolluar dhe profesionalisht të përgatitur do t'i bashkohen trupës së oficerëve të FSK-së".

Gjithashtu, në Ambasadën e Kosovës në Shkup, në prani të ambasadorit, z. Ylber Hysa, zëvendës ministrit të Mbrojtjes së Maqedonisë, z. Bekim Maksuti dhe të oficerëve të lartë të FSK-së dhe të Akademisë së Maqedonisë, dhanë betimin dy kadetë të rinj të FSK-së, pjesëtarë të komuniteteve të cilët, për katër vite do t'i vazhdojnë studimet në akademinë ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostollski" në Shkup.

Ministri Demolli dekoroi me medaljen "Shërbim i shquar" atasheun e Mbrojtjes së Kroacisë të akredituar për Kosovë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli (20.10.2016) ndau medaljen "Shërbim i shquar" për atasheun e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë i akredituar për Republikën e Kosovës, kolonel Ivica Mateshic me motivacionin për kontributin e dhënë në forcimin dhe avancimin e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, në prag të përfundimit të misionit të tij në vendin tonë. Ministri Demolli e falënderoi kolonelin Mateshic për kontributin e dhënë në forcimin e bashkëpunimit të dy ministrive, dy forcave si dhe të dyja vendeve në fushën e sigurisë, duke potencuar faktin se angazhimi i atasheut kroat të Mbrojtjes ka qenë i shkëlqyer dhe se ka ndikuar drejtpërdrejtë në forcimin dhe avancimin e marrëdhënieve tona dypalëshe në këtë fushë. Nga ana e tij, atasheu i Kroacisë, Ivica Mateshic, ka falënderuar ministrin Demolli për vlerësimin, duke potencuar se kur ka marrë detyrën për atashe në Kosovë është ndjerë si në shtëpinë e tij, duke e konfirmuar se po ashtu edhe sot ndjehet i tillë. Theksojmë se atasheu i Kroacisë, kolonel Ivica Mateshic, në gjuhën arbëreshe dhe nën emocione shprehu krenarinë për prejardhjen e tij familjare, duke theksuar se rrjedh nga një familje arbëreshe nga rrethinat e qytetit të Zarës në Kroaci.

Certifikohen oficerët e rinj të FSK-së nga radhët e komuniteteve

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS) të FSK-së në Ferizaj, (21.10.2016) u mbajt ceremonia e certifikimit të oficerëve të rinj nga radhët e komuniteteve të cilët kryen kursin integrues për oficerë të rinj. Kursi integrues zgjati 6 javë dhe u realizua nga instruktorët e Qendrës së Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve (QZHPU), në të cilën morën pjesë katër oficerë nga radhët e komunitetit serb-boshnjak të sapo diplomuar në Akademinë Ushtarake në Shkup dhe një oficere e cila ka kryer Akademinë Ushtarake në Turqi, të cilët kanë fituar gradën nëntoger. Oficerët e rinj gjatë kësaj periudhe të shkollimit përcollën këto module; Lidershipi dhe menaxhimi, operacionet, fitnesi fizik, rregulloren rreshtore, navigimi tokësor, trajnim me armë, dhe procedurat udhëheqëse të trupave. Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i QZHPU-së, nënkolonel Adem Haxhosaj, AzeminaCullum, shefe e Zyrës për Komunitete në MFSK-së, si dhe oficerë të KDS-së. Me këtë rast, komandanti i KDS-së,



gjeneral brigade Enver Cikaqi pasi uroi oficerët e rinj, për suksesin e arritur në akademitë ushtarake në Maqedoni dhe Turqi, ndër të tjera, tha: "Diplomimi i oficerëve të rinj nga radhët e komuniteteve shënon një hap të rëndësishëm në zhvillimin dhe ngritjen e FSK-së. Programi mësimor i Kursit Integrues për Oficerë të Rinj (KIOR) shërben për të edukuar, trajnuar dhe për të inspiruar oficerët e rinj që pas përfundimit të KIOR-it të përshtaten lehtë me sistemin e shërbimit në FSK, duke demonstruar kompetencë dhe vetëbesim, të jenë fizikisht dhe mentalisht të fortë për të udhëhequr me njësitet e tyre sipas standardeve të FSK-së, të jenë me moral dhe me etikë të lartë, të gatshëm për udhëheqje me njësite. Duke iu drejtuar oficerëve të rinj, gjeneral Cikaqi kërkoi nga ta që të integrohen në FSK, aty ku do të emëroheni në detyra të reja nëpër njësi, dhe të angazhoheni për të sjellë kreativitetin, motivimin dhe këmbënguljen për të kryer çdo detyrë apo punë që ju është besuar. Përgatitja e oficerëve të rinj në këtë kurs u fokusua në filozofinë e drejtimit, moralin dhe etikën e ushtarakut, teknikën në përvetësimin e përdorimit të armatimit dhe të njohurive themelore ushtarake të nivelit taktik.

FSK-ja, pjesëmarrëse në samitin e grave lidere të organizuar nga Garda Kombëtare e Ajovës-SHBA

Në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Gardës Kombëtare të Ajovës (SHBA), një delegacionin i MFSK/FSK-së, më 7 tetor 2016, udhëhequr nga kolonel Irfete Spahiu, zëvendës komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), toger Mimoza Budeci-oficer e ndërlidhjes në Departamentin për Bashkëpunim dhe Siguri me zyrën e ODC-së, pranë Ambasadës së SHBA-ve dhe znj. Krenare Sogojeva-Dermaku, drejtoresh e Departamentit Ligjor në Ministrinë për FSK-në, në shoqërim të oficerit për marrëdhënie bilaterale pranë Ambasadës së SHBA-së major Jodie E. Marti, qëndruan për një vizitë zyrtare, një javore, në shtetin e Ajovës-SHBA.

Qëllimi i vizitës së delegacionit të MFSK/FSK-së, ishte pjesëmarrja në samitin e grave lidere të organizuar nga Garda Kombëtare e Ajovës.



Certifikohen 49 pjesëtarë të FSK-së në trajnimin "Taktikat me Njësi të Vogla" në BRSH-Istog

Në Kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së në Istog, më 21. 10. 2016 u mbajt ceremonia e certifikimit të 49 pjesëtarëve të FSK-së, pas përfundimit me sukses të trajnimit "Taktikat me Njësi të Vogla".

Në ceremoni i pranishëm ishte edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i cili me këtë rast, tha se: "Trajnimi-Taktika me Njësi të Vogla, ju përgatitë dhe do të ju ndihmojë në përmbushjen e detyrave në njësitë e juaja, qoftë në misionin aktual gjithashtu në misionin e ardhshëm, kurse pjesëmarrja e komuniteteve e begaton edhe me shumë këtë trajnim. Qëllimi jonë është që të ndërtojmë një forcë profesionale dhe multietnike, në mënyrë që kurdo që kërkohet nga ne, të jemi të gatshëm t'i shërbejmë vendit.

Ky trajnim ka dëshmuar se është shumë i suksesshëm duke marrë parasysh rezultatet që pjesëtarët e FSK-së, kanë treguar në angazhimet me ushtritë në vendet



rajonale dhe në pjesëmarrje në gara të ndryshme ndërkombëtare. Të gjitha zhvillimet në FSK i kemi bërë në bazë të standardeve të NATO-s dhe për këtë FSK-ja është e gatshme të nderveprojë me të gjitha vendet e NATO-s.

Të punojmë fort që kurdo që merret vendimi politik ne të jemi të gatshëm që t'i shërbejmë vendit tonë.

Ndërsa, komandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci tha: "Brigada e Reagimit të Shpejtë është duke vazhduar të realizojë me profesionalizëm, disiplinë dhe angazhim maksimal të gjitha aktivitetet trajnuese të planifikuara për vitin 2016, me synim kryesor arritjen e qëllimit dhe objektivave të Komandantit të FSK-së.

Pjesëtarët e BRSH-së, si në nivelin individual ashtu edhe në atë kolektiv, në vazhdimësi, po përfaqësojnë në mënyrën më të mirë veten e tyre, por dhe institucionin dhe shtetin tonë, dhe këtë po e dëshmojnë rezultatet e larta, që po arrijnë si në gara ashtu edhe në shkollime dhe trajnime. Pjesëmarrja në trajnime dhe gara vendore dhe ndërkombëtare është duke e rritur nivelin profesional dhe është duke ndikuar ndjeshëm në rritjen e aftësive operuese të njësisë tonë.

Trajnimi "Taktikat me Njësi të Vogla" është trajnim i cili është dhe do të mbetet prioritet i BRSH-së, edhe gjatë viteve në vazhdim. Temat që praktikohen në këtë trajnim janë tema, që do të trajnohen edhe në misionin e ardhshëm, prandaj është shumë e rëndësishme për BRSH-në, të mbajë dhe të avancojë nivelin e këtij trajnimi.

Në fund kolonel Geci, uroj të gjithë pjesëtarët, për përfundimin me sukses të trajnimit "Taktikat me Njësi të Vogla', dhe njëherë kërkoj nga ta, që njohuritë e fituara të shërbejnë për realizimin sa më profesional të detyrave në kuadër të misionit si dhe të shërbejnë për të mirën e qytetarëve dhe Republikës tonë".

Gjatë këtij trajnimi pjesëtarët e FSK-së, janë pajisur me njohuri, në teori dhe në praktikë, në fusha të ndryshme, ndërsa fokusi kryesor gjatë trajnimi ka qenë ngritja dhe profesionalizimi i pjesëtarëve të BRSH-së dhe njësive të tjera të FSK-së, për kryerjen e detyrave taktike për realizimin sa më mirë të misionit të tanishëm dhe atë të ardhshëm.

Kurse atasheu ushtarak i SHBA-ve, koloneli Ficsher u nda i kënaqur me të arriturat e BRSH-së. Ai falënderoi kolonel Gecin dhe stafin e tij, për pritjen e organizuar.

Për pjesëtarët të cilët kanë përfunduar këtë trajnim u ndanë certifikata dhe shpërblime për më të dalluarit, ndërsa, mirënjohje, për instruktorët.

Zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore priti në takim lamtumirës zëvendëskomandantin e KFOR-it

Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, më 3 tetor 2016, priti në një takim lamtumirës zëvendëskomandanti e KFOR-it, gjeneral brigade Fierenc Korom, të shoqëruar nga pasuesi i tij, gjeneral brigade Christian Reiner.

Gjatë takimit të përbashkët që zhvilluan gjeneralët; gjenerali Hazrolli falënderoi gjeneralin Korom për mbështetjen e vazhdueshme gjatë kohës sa ka qenë në shërbim në Kosovë, dhe njëkohësisht i dëshiroi shëndet dhe suksese gjeneralit, të sapoemëruar, Christian Reiner, në punët që e presin në të ardhmen, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe bashkëpunim të suksesshëm.

Me këtë rast, gjeneral Hazrolli e njoftoi gjeneralin Reiner për projektet e përbashkëta që Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka pasur me KFOR-in në të kaluarën, në një varg fushash si në realizimin e ushtrimeve, garave dhe bashkëpunimeve tjera, të cilat janë realizuar gjatë mandatit të kaluar.

Në këtë takim u bisedua edhe për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e KFOR-it në ushtrimin fushor, , Shqiponja 5", ushtrim ky i cili është me prioritet, ku gjeneral Hazrolli kërkoi ndihmën e KFOR -it dhe të gjithë aktorëve të tjerë, për realizmin me sukses të këtij ushtrimi.



FSK-ja dhe KFOR-i amerikan zhvillojnë ushtrimin e përbashkët për evakuim mjekësor në KDS

FSK-ja, në kuadër të ushtrimit fushor kursi i "Lideri Luftarak" në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, më 5 tetor 2016, së bashku me një Ekip të specializuar për evakuime mjekësore nga KFOR-i amerikan "Bondsteel", zhvilloi ushtrimin fushor për evakuimin mjekësor të të lënduarve.

Ekipi i KFOR-it amerikan, fillimisht ligjëroi përmes një brifingu rreth procedurave; dhënien e ndihmës së parë në vendngjarje, mënyrën e bartjes së tyre dhe vendosjen e tyre në helikopter, si dhe procedurave tjera gjatë këtij procesi.

Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi falënderoi ekipin amerikan për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe përkushtimin e tyre në aftësimin profesional të ushtarëve të FSK-së, kurse nga kursantët e FSK-së, kërkoj që të angazhohen maksimalisht në përvetësimin e njohurive të reja nga instruktorët amerikanë.

Ushtrimin për evakuimin mjekë-



sor të të lënduarve e kanë mbikëqyrë rreshter majori i KDS-së, Xhevdet Mataj së bashku me rreshter majorin amerikan Timothy Hileman, të cilët janë ndarë të kënaqur me rrjedhat e ushtrimit, bashkëpunimin e ndërsjellë dhe përvojat e fituara.

"Kjo është një eksperiencë e mirë për pjesëtarët e FSK-së, të cilët mund të ballafaqohen me situata reale në të ardhmen" tha rreshter majori Xhevdet Metaj, i cili falënderoi KFOR-in amerikan për mbështetjen me pajisje, personel të specializuar dhe me helikopter, në përmbushjen e objektivave të "aktiviteteve trajnuese" në kuadër të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së.

Komandanti i KDS-së vizitoi ushtarët gjatë trajnimit për Kërkim-Shpëtim në male

Komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi gjatë vizitës të ushtrimit përgëzoi kursantët dhe instruktorët e FSK-së, si dhe i sigurojë ata për mbështetjen e pakursyer të KDS-së për realizimin e këtij trajnimi. Gjeneral Cikaqi gjithashtu kërkoi nga kursantët që të angazhohen maksimalisht në përvetësimin e njohurive të reja, kurse nga instruktorët e tyre angazhim profesional për aftësimin e kuadrove.

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, më 5 tetor 2016, i vizitoi ushtarët e FSK-së, pjesëmarrës në kursin e "kërkim-shpëtimit në male" i cili po zhvillohet në Strazhë të Kaçanikut.

Me këtë rast, Ai i përgëzoi kursantët dhe instruktorët e FSK-së, si dhe i sigurojë ata për mbështetjen e pakursyer të KDS-së për realizimin e këtij trajnimi. Gjeneral Cikaqi gjithashtu kërkoi nga kursantët që të angazhohen maksimalisht në përvetësimin e njohurive të reja, kurse nga instruktorët e tyre angazhim profesional për aftësimin e kuadrove.

Qëllimi i mbajtës së këtij trajnimi është që ushtarët e FSK-së të përgatiten rreth përdorimit të teknikave sa më profesionale për ndihmë viktimave në male, siç është teknika me litar e cila mundëson ngritjen dhe uljen e viktimave sipas nevojës, qoftë nga vendet e larta në të ulëta dhe anasjelltas, qoftë nga vendet e izoluara.

FSK-ja, Garda Kombëtare e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë mbajtën krosin me moton "Së bashku për paqe"



Në sheshin "Skënderbeu" të Prishtinës, në organizim të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të MFSK-së, më 20 tetor 2016, mbajtën krosin në atletikë, ku morën pjesë mbi 300 pjesëtarë të FSK-së, pjesëtarë të Gardës Kombëtare të Ajovës dhe pjesëtarë të Ushtrisë Amerikane për Evropë.

Në hapjen zyrtare të garës morën pjesë: Ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral brigade Thimoty Orr, drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, si dhe zyrtarë të Ministrisë dhe oficerë të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës.

Në fjalën e tij, drejtuar ushtarëve dhe oficerëve të Gardës Nacionale të Ajovës, Forcave Amerikane dhe të FSK-së, ministri Demolli tha se aktivitetet e tilla po mbahen me qëllim të thellimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës.

"Përpos vizitave në shtetin e Kosovës po zhvillojmë edhe këtë kros. Këto dy forca përveç aktiviteteve ushtarake, siç janë ushtrimet e përbashkëta fushore dhe trajnimet, po zhvillojnë edhe aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive, siç është edhe ky kros me sloganin "Së bashku për Paqe".

Në fund ministri Demolli përgëzoi sportistët duke ju uruar suksese të gjithë pjesëmarrësve dhe duke jua rikujtuar se fituesit e garës do të shpërblehen me medalje.

Ndërsa, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral brigade Thimoty Orr, pas i uroi pjesëmarrësit, ndër tjera tha se, "fuqia e shteteve tona është në zemrat tona" dhe pres t'i nderojë me medalje fituesit.

Ndërkaq, drejtori i Drejtorisë për Operacione gjeneral brigade Zymer Halimi, tha se, edhe ky aktivitet i përbashkët dëshmon më së shumti bashkëpunimin për paqe në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës.

Gara filloi në shtegun, nga Sheshi "Skënderbeu" deri te rreth-rrotullimi, afër Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Dr. Ali Sokoli", në Prishtinë dhe anasjelltas, në një gjatësi prej 5 mijë metrave. Vendin e parë në këtë garë në kategorinë e meshkujve e zuri Jesemin Zverko, të dytin Valdet Brahimi dhe në vendin e tretë u rendit Adnan Ademi, që të tre pjesëtarë të FSK-së, kurse në kategorinë e femrave vendin e parë e zuri ushtarja Donjeta Korpuzi, vendi i dytë i takoi pjesëtares së Ushtrisë Amerikane, rreshter Stefany Stock dhe në vendin e tretë u rendit ushtarja Bahare Bytyçi,

Tri vendet e para u nderuan me medaljen e artë, argjendtë dhe të bronztë si dhe me certifikata, të cilat u ndanë nga ministri i FSK-së, Haki Demolli, zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione.

Garat sportive po zhvillohen në kuadër të aktiviteteve të ushtrimit fushor "Shqiponja 5" të FSK-së, i cili do të mbahet nga data 22 deri më 26 tetor 2016.

Ky aktivitet sportiv, në një mot të mirë, u përcoll nga një numër i madh i qytetarëve dhe mediave vendore.





Reshteri i FSK-së Florim Bujupi nderohet me medaljen e artë në gjuajte me armë në Kampin Bondstell të KFOR-it amerikan



Në kampin e KFOR-in amerikan në Bonsteel, është mbajtur gara-gjuajtja me armë, për përzgjedhjen e ushtarit më të mirë. Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së e kanë përfaqësuar, në çdo disiplinë, me nga dy pjesëtarë. Arritjet e pjesëtarëve të FSK-së në këtë garë kanë qenë ndër më të mirat, ku nga 8 nënoficerë pjesëmarrës, tre nga ta, janë shpallur ndër gjuajtësit më të mirë dhe janë shpërblyer me medaljen e artë dhe të argjendtë. Rreshteri Florim Bujupi është shpërblyer me medaljen e artë, pasi që i njëjti ka kaluar me sukses të plotë të gjitha disiplinat në gjuajtje me: Pistoletë Hekler P8 kalibri 9x19 nga 5 fishekë për gjashtë sekonda, distanca 25 metra, pozicioni në këmbë;pistoletë Hekler P8 kalibri 9x19 nga 5copë fishekë dhe një shpejtësi prej 6 sekonda, distance 25 metra pozicioni shtrirë, në gjunjë dhe në këmbë (tri disiplina) medaljen e art, mitraloz Mashingan MG-3, kalibri 7. 62x51mm NATO, 15 fishekë distancë 300 metra. Rreshteri Bujupi për gazetën "Forca Jonë", tha: "Ndihem i lumtur që ish më i miri, kurse Medalja e artë është edhe një obligim shtesë që të punojë më shumë" është shprehur rreshteri Florin Bujupi. Kurse medalja e argjend i takoi kapter Enver Ahmetit dhe tetar Arben Reshanit, të dy pjesëtarë të Komandës Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj.

Studentët amerikanë vizituan FSK-në

Më 10 tetor 2016, studentë amerikanë të Universitetit të Kopenhagës, të kryesuar nga profesoresha e këtij universiteti, znj. Trine Schultz dhe profesori i Universitetit "Dardania" Zekë Çeku vizituan Ministrinë për FSK-në, të cilët, për të arriturat e FSK-së, i njoftoi nënkolonel Agron Bajrami drejtor i Departamentit për Transformim, Modernizim, Standardizim, duke u fokusuar në "misionin dhe detyrat e FSK-së; ministrinë e integruar, strukturën e FSK-së, edukimin dhe trajnimet, më fokus të veçantë tek "ushtrimet"; operacionet dhe partnerët ndërkombëtar" si dhe për ndryshimin e misionit dhe strukturës nga FSK në Forcat e Armatosura të Kosovës. Gjatë këtij prezantimi studentët amerikanë të Kopenhagës shfaqen interesim për shumë çështje sa i përket trajnimeve, kadetëve të FSK-së, ushtrimeve, marrëveshjeve dhe aplikimin e të rinjve në FSK. Ata u interesuan edhe për urën lidhëse ndërmjet FSK-së dhe NATO-s, si dhe profesionalizmin e FSK-në, në raport me vendet tjera. Ata patën mundësi bashkëbisedimi edhe me kolonel Ilir Qeriqin, drejtori i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim dhe nënkolonel Agron Bajrami, ku edhe parashtruan pyetje të shumta.



FORCA JONË

Viti V • Nr. 53 •Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

DITA E FORCËS – DITË E HAPUR

FSK në shërbim të qytetarëve



Prishtinë, 27 nëntor 2016

Përmbajtja

Punë, përkushtim dhe profesionalizëm i lartë në FSK....3
Viti 2016, vit i sukseseve të FSK-së....4
FSK-ja fitoi medaljen e artë në garën "Cambrian Patrol" në Britani të Madhe....5
Oficeri i FSK-së Ismajl Hoxha shpallet më i miri në Akademinë Mbretërore Ushtarake "Sandhurst" të Anglisë....5
Togerja e FSK-së Manushaqe Nura e para në Garën Ndërkombëtare të mbajtur në Republikën e Kroacisë....6
Rreshteri i FSK-së shpërblehet me medaljen e artë....6
Pjesëtari i FSK-së zuri vendin e parë në garën e vrapimit "Run for the Fallen"në Bondstill....7
FSK-ja përuroi Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim....7
Memorandum bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Hungarisë....8
Ministri Haki Demolli priti asistentin për operacione të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Patrick Turner....8
Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë takoi ministrin dhe komandantin e FSK-së....9
Ministri Haki Demolli priti ministrin e Mbrojtjes së Kroacisë Josip Buljeviç....10
Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën admiralin Mark Ferguson III....11
Ministri Demolli dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama zhvilluan takime të rëndësishme në Pentagon, Uashington DC dhe në shtetin Ajova....11
Kongresi Amerikan përkrah Kosovën në Programin e Partneritetit për Paqe....12
Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s në Romë....12
Gjenerali amerikan Timothy Orr vizitoi njësitet e FSK-së....13
Ministri i FSK-së Haki Demolli priti drejtorin e Divizionit për Plane dhe Politika të NATO-s....13
NATO mandaton Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës për Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në....14
Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerali Hodges: FSK-ja e gatshme pret vendimin politik për transformim....15
Komandanti i FSK-së u prit në Romë nga shefi i Forcave të Armatosura të Italisë....15
Ushtarakë të Gardës Kombëtare të Ajovës vizituan MFSK-në dhe KFT-në....16
Ministri Haki Demolli takoi gjeneralët amerikan Altman dhe De Haes nga Garda Kombëtare e Ajovës....16
U mbajt konferenca e 5-të "FSK dhe Partnerët"....17
Ministri Haki Demolli priti zv. asistentin për operacione të Sekretarit gjeneral të NATO-s John Manza....18
Gjenerallejtënant Rrahman Rama pjesë e konferencës ushtarake në SHBA....18
FSK-ja pjesëmarrëse në samitin e grave lidere të organizuar nga Garda Kombëtare e Ajovës-SHBA....18
Manifestime dhe homazhe: FSK-ja parakaloi në 8- vjetorin e Pavarësisë....19
Në FSK u mbajt manifestimi qendror "Epopeja e UÇK-së"....19
Drejtusit e FSK-së homazhe në Memorialin e Reçakut....21
Ministri dhe komandanti i FSK-së nderuan dëshmorët e UÇK-së në "Epopenë e Dukagjinit"....21
Ministri dhe komandanti i FSK-së bënë homazhe në "Varrezat e Dëshmorëve" në Koshare....21
FSK-ja përfundoi me sukses operacionet e deminimit humanitar për vitin 2016....22
Pjesëtarët e FSK-së dhuruan mbi 1200 doza gjak për qytetarët e Kosovës....22
FSK-ja në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën"....23
FSK-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Tokës....23
FSK-ja më e besueshmja në Republikën e Kosovës....24
Kadetët e FSK-së për dy javë realizuan ushtrimin fushor "Kampi veror 2016" në Zhegoc të Gjilanit....24
Kadetët e FSK-së dallohen me paraqitjen e suksesshme gjatë operacioneve në "Kampin veror 2016" në Krivollak të Maqedonisë....24
FSK-ja në stërvitjen e përbashkët "Joint Effort-1" në Shqipëri....25
Kontingjenti i FSK-së në operacionet e përbashkëta në ushtrimin "Reagimi i Menjëhershëm 16" në Slloveni- Kroaci....26
FSK-ja zhvilloi me sukses ushtrimin fushor "Shqiponja 5"....26
Ministri Demolli vizitoi ushtrimin fushor "Shqiponja 5"....27
Kadetët e FSK-së student në "WestPoint"....28
Diplomojnë kadetët e rinj të FSK-së, gjenerata 2016....28
Betohen kadetët e rinj të FSK-së....29
Diplomojnë kadetë minoritar të FSK-së....30
FSK trajnoi "Ekipin për parashutistë"....30
Në kazermën „Adem Jashari " të FSK-së u përurua Salla e sporteve....32
FSK-ja, Garda Kombëtare e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë mbajtën krosin me moton "Së bashku për paqe"....33

Punë, përkushtim dhe profesionalizëm i lartë në FSK



Forca e Sigurisë së Kosovës me angazhimin konkret dhe të përkushtuar, nga nëntori i vitit të kaluar dhe deri më tani, po përmbyll edhe një vit mjaft të suksesshëm të zhvillimit, profesionalizimit dhe suksesit të gjithmbarshëm në të gjitha rrafshet si vendore ashtu edhe ndërkombëtare.

Me punë serioze dhe disiplinë, me një planifikim të mirë të stafit komandues të FSK-së dhe njësive të saj si dhe me një menaxhim të mirë dhe funksionim efikas të komandës dhe kontrollit, FSK-ja ka shënuar suksese në realizimin e misionit të saj, ka kryer me sukses të gjitha detyrat, duke qenë aktive dhe bashkëpunuese me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë si dhe ndërvepruese me ushtritë e vendeve partnere në regjion dhe më gjerë.

Rezultatet e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë të dukshme dhe të matshme, së pari është shkalla e besueshmërisë së FSK-së tek qytetarët e vendit, gjë që shihet edhe nga rezultatet e sondazheve të opinionit publik, që FSK-në me vite e radhitin ndër institucionet me besueshmëri të lartë, pastaj shpërblimet që njësitë dhe pjesëtarët e FSK-së kanë fituar qoftë në gara individuale qoftë ekipore ku janë stolisur me medalje të artë, e gjithashtu edhe sukseset e kontingjenteve të FSK-së të treguara në ushtrimin e përgjithshëm vjetor të FSK-së, në bashkëpunim me institucionet tjera emergjente vendore, pastaj ushtrimet me KFOR-in si dhe ushtrimet regjionale dhe më gjerë në të cilat FSK-ja ka dëshmuar se është në rrugë të mirë për të qenë në hap me ushtritë tjera.

FSK-ja ka shënuar sukses në integrimin e gjinisë femërore dhe komuniteteve pakicë në radhët e saj dhe ka treguar përkushtim në krijimin e një ambienti pune të përshtatshëm dhe ekuivalent. Këtë vit, kanë diplomuar edhe oficerët e parë të FSK-së nga radhët e komunitetit serb, të cilët në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, kanë kryer Akademinë Ushtarake në Republikën e Maqedonisë, për t'u integruar të gjithë bashkë për shërbim në FSK, pa dallim.

Me këtë rast dua të theksoj edhe bashkëpunimin e mirë që Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdojnë ta kenë me Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK dhe FSK, bashkëpunimin e mirë me Gardën Kombëtare të Ajovës dhe me partnerë tjerë strategjikë. Po këtë vit kemi pasur bashkëpunim të mirë me vendet fqinje, kemi dhënë kontributin tonë në nismat regjionale të sigurisë, në të mirë të paqes dhe sigurisë jo vetëm në regjion por edhe më gjerë. Me qellim të realizimit të procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK) dhe realizimin e objektivave strategjikë, MFSK-ja ka dorëzuar projekt-amendamentet kushtetuese për ndryshim të Kushtetutës, që t'i hapë rrugë transformimit të FSK-së në FAK. Po ashtu është dërguar edhe Projektligji për Transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës. Këto projektligje sipas procedurës i janë dorëzuar Qeverisë, e cila tashmë ia ka dorëzuar Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Forca e Sigurisë së Kosovës me aktivitet e saja të shumta dhe të gjithanshme, me angazhim dhe punë të përkushtuar, të bazuar në standarde profesionale ushtarake, ka realizuar të gjitha detyrat e planifikuara, prandaj me të drejtë konstatojmë se FSK-ja ka dëshmuar fuqishëm se është në lartësinë e detyrës për të marrë mision të ri, misionin për krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Haki Demolli
Ministër për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti 2016, vit i sukseseve të FSK-së



Sot është një ditë e rëndësishme, meqë po shënojmë përvjetorin e tetë të themelimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që për një kohë shumë të shkurtër u shndërrua në institucionin më të besueshëm në vend. Forca e Sigurisë së Kosovës, si forcë e uniformuar, profesionale, shumetnike, lehtë e armatosur dhe që i nënshtrohet kontrollit civil demokratik, që nga themelimi i saj në vitin 2009, është e përkushtuar në ngritjen profesionale dhe zhvillimin e kapaciteteve në përmbushje të misionit të saj kushtetues për zbatimin e operacioneve të reagimit ndaj krizave, mbështetjes së autoriteteve civile dhe ndihmës së qytetarëve të Republikës së Kosovës, pa dallim. FSK është ngritur, zhvilluar dhe avancuar në një afat të shkurtër kohor, në harmoni me standardet e NATO -s dhe në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me partnerët tanë, duke u bërë kështu kontribuuese e sigurisë dhe institucioni më i besueshëm në vend. Për më tepër, synimi ynë kryesor është që FSK të bëhet forcë e ndërveprueshme, partner i besueshëm dhe kontribuuese e sigurisë në regjion dhe në botë, përkrah partnerëve tanë. Forca e Sigurisë së Kosovës, falë angazhimit dhe profesionalizmit të pjesëtarëve të saj që tri vite rresht është shpallur institucioni më i besueshëm në vend. Ky besim i qytetarëve na ka dhënë motiv shtesë që të jemi edhe më të përkushtuar dhe më afër qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke iu krijuar një ambient të sigurt dhe duke ua përmirësuar kushtet e jetës. Edhe gjatë këtij viti FSK-ja ka vazhduar me pastrimin e fushave nga mjetet e rrezikshme, duke demoluar dhe shkatërruar qindra mjete të pashpërthyera. Njëkohësisht, FSK gjatë këtij viti ka kryer me dhjetëra projekte humanitare në gjithë Kosovën, duke përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet e jetesës së qytetarëve të saj. Gjithashtu, me kapacitetet e veta të kërkim-shpëtimit, me kapacitete mjekësore dhe të tjera iu ka qëndruar afër qytetarëve të Republikës së Kosovës duke asistuar dhe iu dhënë ndihmën e nevojshme. Forca e Sigurisë së Kosovës, është forcë shumetnike që pasqyron diversitetin etnik të qytetarëve të Republikës së Kosovës me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim gjinie dhe etnie. FSK është e përkushtuar që t'i integron të gjitha komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës, duke iu dhënë mundësi të barabartë për zhvillim dhe edukim. Këtë vit kemi të diplomuarit e parë nga radhët e komunitetit serb, të cilët kanë diplomuar në Akademinë Ushtarake të Maqedonisë. Këta oficerë të rinj janë integruar nëpër njësi dhe me krenari i shërbejnë vendit. Forca e Sigurisë së Kosovës është duke punuar intensivisht për zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të saj si në vend ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, duke synuar të bëhet forcë e ndërveprueshme, partner i besueshëm dhe kontribuuese e sigurisë në regjion dhe në botë. Gjatë vitit 2016, FSK ka dërguar kadetë në akademi ushtarake në gjashtë vende të botës, përfshi këtu edhe, për herë të parë, dy kadetë në akademinë prestigjioze të SHBA-ve, West Point. Forca e Sigurisë së Kosovës ka organizuar ushtrimin fushorë "Shqiponja 5" ku për herë të parë si pjesë e ushtrimin ishin të ftuar edhe partnerët tanë nga Ushtria Amerikane për Evropë, Garda Kombëtare e Ajovës, KFOR-i dhe shtetet e regjionit. Për më tepër, FSK ka marrë pjesë në katër ushtrime fushore regjionale, ku ka operuar përkrah shumë ushtrive të shteteve partnere, me të vetmin qëllim avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe arritjen e ndërveprueshmërisë me partnerët. Gjithashtu, FSK ka marrë pjesë edhe në gara të ndryshme ushtarake shumëkombëshe në vend dhe jashtë vendit, duke arritur rezultate të shkëlqyeshme si individ dhe si ekip. Këtë vit FSK ka marrë pjesë në garën e ushtarit më të mirë me ushtarët e KFOR-it duke zënë vendin e parë dhe të dytë; në garën ekipore të KFOR-it duke zënë vendin e parë; në garën ndërkombëtare në Kroaci duke zënë vendin e parë në kategorinë e femrave; dhe së fundi në garën "Cambrian Patroll" në Mbretërinë e Bashkuar duke marrë medaljen e artë në një konkurrencë shumë të lartë ku morën pjesë 110 ekipe nga 19 ushtri të shteteve të ndryshme të botës. Forca e Sigurisë së Kosovës do të vazhdon me zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve profesionale, në mënyrë që të jetë e gatshme të përmbushë misionin e saj për mbështetjen e autoriteteve civile dhe qytetarëve të Kosovës. Por njëkohësisht, përderisa jemi duke pritur vendimin për transformim në Forca të Armatosura të Kosovës, ne kemi bërë të gjitha planifikimet dhe përgatitjet e nevojshme për transformim. Forca e Sigurisë së Kosovës synon që së bashku me ndihmën e partnerëve të ndërtojë një force mbrojtëse profesionale, shumetnike, që do të jetë në të mirë të vendit dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe kontribuuese e sigurisë regjionale dhe ndërkombëtare. Me shpresë që edhe viti 2017 do të jetë vit i shumë sukseseve, vit kur ne do të fillojmë zbatimin e planeve tona afatgjate, unë ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen dhe inkurajimin që jeni duke na dhënë çdoherë. Në veçanti dëshiroj të falënderoj të gjithë ushtarët, nënoficerët, oficerët dhe familjet e tyre për sakrificat që bëjnë çdo ditë, vetëm e vetëm që të jemi të përgatitur dhe të gatshëm të përmbushim misionin tonë në shërbim të vendit dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Urime Dita e FSK-së!

Gjenerallejtënant Rrahman Rama
Komandant i FSK-së

FSK-ja fitoi medaljen e artë në garën "Cambrian Patrol" në Britani të Madhe



Skuadra e Brigadës së Reagimit të Shpejtë e Forcë së Sigurisë së Kosovës (FSK), e përbërë prej 8 pjesëtarësh, është dekoruar me Medaljen e artë në një ndër ushtrimet më sfiduese dhe më prestigjioze në botë ,,Cambrian Patrol"në Wells të Mbretërisë së Bashkuar. Ceremoninë e dekorimit me medaljen e artë nga afër e ka ndjekur edhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, i cili duke parë nivelin e sfidave gjatë këtij ushtrimi është ndarë jashtëzakonisht i kënaqur me performancën e skuadrës. Skuadra e FSK-së gjatë zhvillimit të patrullës, edhe pse pjesëmarrëse për herë të parë, ka treguar një profesionalizëm të jashtëzakonshëm duke arritur të njëjtin nivel me njësitë me elite të ushtrive më të zhvilluara në botë.

Në këtë ushtrim përveç 102 skuadrave nga njësi të ndryshme të ushtrisë britanike kanë marrë pjesë gjithsej edhe 18 skuadra mysafire, përfshirë ushtritë nga vendet si Gjermania, Italia, Zvicra, Kanadaja, Pakistani, Nepali, Brazili, Kili, Bosnja dhe Hercegovina, Irlanda, India, Belgjika, Çekia, Australia, Zelanda e Re, Gjeorgjia, Meksika, dhe Letonia.

Deri në fazën e 6-të vetëm 10 skuadra përfshirë edhe skuadrën e FSK-së kanë arritur të dekorohen me medaljen e artë, shumë të tjera kanë arritur vetëm ta përfundojnë ose kanë marrë medalje të argjendtë dhe të bronztë, ndërsa 16 skuadra të tjera për arsye shëndetësore apo në mungesë të përgatitjeve të mjaftueshme janë tërhequr nga ushtrimi.

Oficeri i FSK-së Ismajl Hoxha shpallet më i miri në Akademinë Mbretërore Ushtarake "Sandhurst" të Anglisë



Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës Ismajl Hoxha, pas shkollimit njëvjeçar në Akademinë Mbretërore Ushtarake "Sandhurst" në Britaninë e Madhe, fitoi çmimin oficer- kadeti më i mirë ndërkombëtar, duke u bërë kështu oficeri i parë nga Ballkani që fiton një çmim të tillë.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i shoqëruar edhe nga ambasadori i Kosovës në Londër Lirim Grajçevci, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të kadetëve në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst" të Mbretërisë së Bashkuar. Me këtë rast ai theksoi: "Po ndihem shumë i nderuar dhe i privilegjuar që jam sot këtu në cilësinë e komandantit. Është nder dhe është ngjarje historike për Kosovën, por edhe për FSK-në, familjen dhe të gjithë ne".

Oficerit të FSK-së, Ismail Hoxhës gjatë ceremonisë i është dhuruar shpata si shenjë nderimi për çmimin e fituar nga Princi Charles, i cili ka ndarë çmimet më të larta në emër të Mbretërisë së Bashkuar dhe Akademisë Mbretërore angleze. Princi Charli të pranishmëve iu ishte drejtuar "Sot është ditë feste për të kumtuar arritje të mëdha të njerëzve që meritojnë urimet më të ngrohta. Ju po merrni çmimet tuaja në një kohë kur profesioni ushtarak po zhytet në ujëra të turbullta. Shtyllat e rendit ndërkombëtarë janë duke u

sfiduar si kurrë më parë gjatë gjithë jetës time. Në të njëjtën kohë një kult vdekjeje dhe shkatërrimi është duke defiluar nëpër tokat e vjetra, duke joshur një numër të frikshëm të të rinjve që përfundojnë të vdekur. Në ballë të këtyre sfidave, vlerat tradicionale britanike-sjellja e ndershme, qytetërimi, një dozë humori në vështirësi-mbesin po aq të çmuara siç kanë qenë gjithnjë".
Ndërsa, kadeti më i mirë oficer Hoxha është shprehur: "Nuk jam ndjerë asnjëherë më krenar dhe kaq i emocionuar. Kjo është një ditë e veçantë për mua. Ky titull është një privilegj dhe një obligim më shumë, që do ta dëshmoj me punë dhe angazhim në të mirë të FSK-së dhe Kosovës".
Bashkë me oficerin Hoxha diplomuan edhe dy oficerë të FSK-së, Fitore Fazliu dhe Besfort Kruma. Në këtë akademi kane kryer studimet edhe oficerë të tjerë të FSK-së të cilët gjithmonë janë dalluar për performancën e tyre.

Togerja e FSK-së Manushaqe Nura e para në Garën Ndërkombëtare të mbajtur në Republikën e Kroacisë



Në poligonin ushtarak "Gjakovo" në Grubisnjo Polje të Kroacisë, më 11dhe 12 maj 2016, u mbajt ceremonia zyrtare për shpalljen e ushtarit më të mirë për vitin 2016, ku vendi i parë në konkurrencën e femrave i takoi togerr Manushaqe Nura, ndërsa në konkurrencën e meshkujve vendi i tret i takoi tetarit Binak Podrimcaku dhe i 13-ti tetarit Feti Pronaj.
Gara për përzgjedhjen e ushtarit më të mirë, që mbahet çdo vit në Kroaci, është njëra ndër garat ushtarake më të forta në Botë. Në këtë garë kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 15 shteteve të NATO-s, si dhe shumë përfaqësues të shteteve partnere të Kroacisë.
Në garën për përzgjedhjen e ushtarit më të mirë në nivel ndërkombëtar kanë marrë pjesë 145 ushtarë, të cilët kanë marshuar 40 kilometra me 17.6 kilogram ngarkesë në shpinë duke kaluar-ekzekutuar 13 detyra ushtarake. Edhe kësaj here, në këtë garë, FSK-ja u dallua për paraqitjen e saj të shkëlqyeshme, duke dëshmuar përgatitje të lartë profesionale krahas pjesëmarrësve të tjerë të shteteve të NATO-s.

Rreshteri i FSK-së shpërblehet me medaljen e artë



Pjesëtarët e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) janë shpërblyer me Bexhin e Artë dhe të Argjendtë në garën "Ushtari më i mirë në gjuajte", që është mbajtur në kampin Bonstill në Ferizaj si pjesë e bashkëpunimit të KFOR-it amerikan me FSK-në.
Florim Bujupi, rreshter në KDS, është shpërblyer me Bexhin e Artë pasi që ka kaluar të gjitha disiplinat, kurse medalja e argjend iu është dhënë kapter Enver Ahmetit dhe tetar Arben Reshanit, që të dy pjesëtarë të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj.

Pjesëtari i FSK-së zuri vendin e parë në garën e vrapimit "Run for the Fallen"në Bondstill

Pjesëtari i Forcës së Sigurisë së Kosovës Granit Kryeziu, i sistemuar në Batalionin e Parë të Reagimit të Shpejtë (BRSH) në Gjilan, u stolis me medaljen e artë pasi që zuri vendin e parë në vrapimin 5 kilometrash në kategorinë e meshkujve në garën "Run for the Fallen"(Vrapo për të rënët), në kampin e KFOR-it ,,Bonsteel" në Sojevë, si shenjë nderimi për viktimat në shtetin e Pennsylvani-së(SHBA). Pjesëtarët e Batalionit të Parë gjithashtu u stolisën edhe me medalje të bronztë duke zënë vendin e tretë në marshimin "Iron Trail", medalje e cila iu nda rreshter Besim Behlulit. FSK-ja, përkatësisht Batalioni i Parë i Reagimit të Shpejtë, ka marrë pjesë në marshimin 22. 5 kilometra me 15 pjesëtarë me ngarkesë dhe pajisje individuale dhe në vrapimin prej 5 kilometrash me një pjesëtar.



FSK-ja përuroi Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim

Forca e Sigurisë së Kosovës, me një ceremoni madhështore, përuroi Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në kazermën ,,Evropianët e rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të FSK-së në Bardh të Vogël (Pomozatin), e para e këtij lloji në FSK dhe në Kosovë. Me këtë rast, presidenti i vendit njëherësh Komandanti i Përgjithshëm i FSK-së z. Hashim Thaqi tha se: "FSK-ja është treguesi më i mirë i karakterit të shtetit dhe shoqërisë sonë. Ajo po forcohet gradualisht në drejtim të mirëmbajtjes së kapaciteteve operacionale, të gatishmërisë për mbështetje të institucioneve, të komuniteteve, të OJQ-ve dhe të bashkëpunimit më partnerët tanë" .Ndërsa, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës z. Haki Demolli fillimisht falënderoi të gjithë partnerët si Suedinë, SHBA-të dhe Turqinë që kanë ndihmuar rreth ngritjes së Qendrës së Trajnimit, e gjithashtu falënderoi edhe partnerët nga Ekipi i Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s që kontribuuan gjatë këtij procesi shumë të rëndësishëm për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Nga ana e tij, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama foli për sukseset në drejtim të avancimit të kapaciteteve, duke paraqitur me këtë rast edhe rolin, rëndësinë dhe objektivat e FSK-së për Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim. Ndërsa, nikoqiri i ceremonisë, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, kolonel Shaip Haziri, tha: Qëllimi i ngritjes së kësaj qendre është që të ofrojmë trajnime për kërkim-shpëtim nga më të mirat në Evropë. Në fund, të gjithë të pranishmit panë nga afër demonstrimin e aftësive dhe shkathtësive të pjesëtarëve të Regjimentit të Mbrojtjes Civile, në përgjigje profesionale ndaj disa skenarëve me situata të cilat kërkuan reagim emergjent për kërkimin dhe shpëtimin e viktimave të shkaktuara nga tërmeti në situatën e simuluar. Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim e RMC-së ka për mision trajnimin dhe profesionalizimin e pjesëtarëve për përballje me emergjenca të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore si dhe emergjenca tjera. Kjo qendër synon edhe trajnimin e agjencive tjera vendore që merren me këtë fushë dhe mëton të jetë Qendër Rajonale e Ekselencës për kërkim-shpëtim.



Memorandum bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Hungarisë

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës z. Haki Demolli dhe ministri i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Hungarisë z. István Simicskó, më 10 qershor 2016 në Budapest nënshkruan marrëveshjen dypalëshe të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.



Ministri Demolli e ka falënderuar Ministrin Simicsko, shtetin dhe popullin hungarez për përkrahjen e tyre të vazhdueshme për Kosovën, institucionet dhe popullin e saj. "Hungaria e ka përkrahur Kosovën në të gjitha fazat e përpjekjeve të saj për shtet-ndërtim, e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe ka kontribuar në stabilitetin dhe sigurinë e Kosovës, e në veçanti duhet çmuar angazhimin e shtetit të Hungarisë në përkrahje të agjendës së Kosovës për anëtarësim në NATO dhe integrim në Bashkimin Evropian",- tha ministri Demolli.
Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes së Hungarisë, z. Istvan Simicsko e konfirmoi edhe një herë mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Republikës së Hungarisë për Republikën e Kosovës në të gjitha fushat, e sidomos në fushën e integrimeve euroatlantike.
Marrëveshja dypalëshe e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive ka për qëllim bashkëpunimin zyrtar në fushën e arsimimit dhe edukimit, shkëmbimit të përvojave në rrugën e integrimeve euroatlantike, në menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e krizave, të buxhetit, etj.

Ministri Haki Demolli priti asistentin për operacione të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Patrick Turner

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës z. Haki Demolli me bashkëpunëtorë, më 29 janar 2016, priti në një takim asistentin për operacione të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s z. Patrick Turner. Ministri Demolli në emër të Ministrisë dhe FSK-së falënderoi z. Turner për angazhimin e NATO-s përmes KFOR-it për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Republikën e Kosovës, si dhe ekipet këshillëdhënëse dhe ndërlidhëse të NATO-s për FSK-në, të cilat Pakti Veri-Atlantik i ka ofruar në mbështetje të Ministrisë dhe FSK-së.
Ministri Demolli gjatë këtij takimi e njoftoi z. Turner lidhur me bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të FSK-së me KFOR-n, zhvillimin e një varg operacionesh të përbashkëta si kërkim- shpëtimi, etj., si dhe për procesin e transformimit, duke shprehur kështu edhe vizionin e tij për ndërtimin dhe zhvillimin e një Force profesionale me kritere dhe standarde



të NATO-s.

Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, z. Patrick Turner, e njoftoi me zhvillimin e FSK-së, mbështetjen e autoriteteve civile për të gjithë qytetarët e vendit pa dallim, dhe se FSK-ja është e interesuar që t'i zhvillojë edhe më tutje kapacitetet e saj. "Ne kemi punuar ngushtë me DIR-in nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe me ekipet e NATO-s, NAT dhe NLAT për transformimin e FSK-së. "FSK-ja është e gatshme që me kapacitetet e saj të marrë pjesë në operacione të përbashkëta si kontribuuese në ruajtjen e paqes kudo ku paraqitet nevoja, duke e garantuar asistentin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s se FSK-ja do të jetë transparente dhe bashkëpunuese me Qeverinë e vendit, NATO-n dhe partnerët strategjikë gjatë procesit të transformimit",- tha në fund gjeneral Rama.

Nga ana e tij, z. Turner tha se i gëzohet nivelit të bashkëpunimit të MFSK-së dhe FSK-së me KFOR-in dhe me dy trupat e NATO-s. NATO-ja do të qëndrojë këtu, në mënyrë që rajoni i Ballkanit të jetë i stabilizuar dhe i integruar, ngase Kosova e meriton të jetë pjesë e familjes euro-atlantike.

Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë takoi ministrin dhe komandantin e FSK-së

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zhvilluan një takim në mjediset e Qeverisë me komandantin e Komandës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges.

Ministri Demolli e falënderoi gjeneralin Hodges për angazhimin e ushtarakëve amerikanë në kuadër të KFOR-it, përkushtimin e SHBA-së për Kosovën e në veçanti të ushtrisë amerikane dhe Gardës Kombëtare të Aiovës. Më tej ministri Demolli e njoftoi gjeneralin Ben Hodges me zhvillimin dhe avancimin e FSK-së, si dhe me përgatitjet për transformimin e saj në Forca te Armatosura.

Ndërsa komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama, e njoftoi gjeneralin Hodges me misionin, strukturën, kapacitetet, gatishmërinë operacionale të FSK-së, si dhe për suksesin e FSK-së në ndërtimin e raporteve të bashkëpunimit me shumë prej ushtrive të vendeve të NATO-s, si dhe operacionet e realizuara sipas misionit në të mirë të vendit dhe gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ndërkaq, rrjedhën e procesit të transformimit të FSK-së e paraqiti shefi i Zyrës për Transformim, nënkolonel Jeton Dreshaj, i cili i njoftoi hollësisht gjeneralin Hodges dhe delegacionin amerikan mbi planin e transformimit.

Nga ana e tij, komandanti i Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges, u shpreh i kënaqur me prezantimin e planit për transformimin e FSK-së. ‚Jam i impresionuar më kualitetin e planit. Planet e mira



janë optimiste për të ardhmen dhe vendimet e juaja. Një plan i brendshëm, vendimi për transformim dhe kur udhëheqësit politikë bëjnë atë që duhet në lidhje me legjislacionin, atëherë FSK do të jetë gati që ta bëjë pjesën e saj, dhe me të vërtetë mezi po presim që kjo të ndodhë."

Ministri Haki Demolli priti ministrin e Mbrojtjes së Kroacisë Josip Buljeviç

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës(MFSK), Haki Demolli, më 7 mars 2016, me një ceremoni shtetërore priti në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë z. Josip Buljeviç.
Të dy ministrat, Demolli dhe Buljeviç, gjatë takimit biseduan për bashkëpunimin e mirë ndërmjet të dyja vendeve-ministrive, si dhe për gatishmërinë për intensifikimin dhe thellimin e këtyre marrëdhënieve në të ardhmen.
Gjatë takimit të përbashkët të dy delegacionet shpalosen perspektivën e marrëdhënieve dypalëshe në mes dy ministrive, si dhe diskutuan për mbështetjen që Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kroate po japin në aspektin e arsimimit, trajnimit dhe ngritjes profesionale të oficerëve, nënoficerëve dhe kadetëve të Forcës së Sigurisë, në shkollat dhe qendrat e saj trajnuese dhe në Akademinë e Mbrojtjes kroate.
Ministri i FSK-së gjatë takimit e informoi ministrin Buljeviç edhe lidhur me procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, si dhe kërkoi nga Ai mbështetje dhe përkrahje për Kosovën në rrugën e saj drejt anëtarësimit në iniciativa ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes, me theks në "Adriatik 5", RACVIAC, e në organizma tjerë ndërkombëtarë, në të cilat Kosova ende nuk është anëtare.
Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, Josip Buljeviç u shpreh se Kosova është e rëndësishme për Republikën e Kroacisë. Urë lidhëse mes Kroacisë dhe Kosovës janë shqiptarët që jetojnë në Kroaci, pastaj kontributi i shqiptarëve në ditët më të vështira për Kroacinë si dhe historia jonë e përbashkët.
Më pas ministri kroat tha se, nuk do të mungojë mbështetja e Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë dhe shtetit kroat për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në NATO.



Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën admiralin Mark Ferguson III

Ministri i FSK-së z. Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama më 28 prill takuan komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara të Aleancës (KFBA) në Napoli, admiralin Mark Ferguson III, i cili shoqërohej edhe nga komandanti i Forcave Paqeruajtëse të KFOR-it, gjeneral major Guglielmo Luigi Miglieta.
Ministri Demolli, me këtë rast, njoftoi admiralin Ferguson me të arriturat dhe zhvillimet e përgjithshme në MFSK dhe FSK, bashkëpunimin me KFOR-in, me ekipet këshilluese ndërlidhëse të NATO-s për FSK-në, me dinamiken e zhvillimeve të FSK-së, vizitën e realizuar në SHBA dhe në veçanti për zhvillimin e proceseve në FSK.
Nga ana e tij, komandanti i Komandës së Bashkuar të Forcave të Aleancës në Napoli, admirali Ferguson, vlerësoi lart zhvillimet dhe të arriturat e FSK-së. Ai shtoi se siguria në Kosovës është jashtëzakonisht e mirë dhe se Kosova është një histori suksesi, kurse KFOR-i në Kosovë do t'i mbajë edhe më tej forcat e veta me kapacitetet që ka më qëllim të ofrimit të sigurisë së përgjithshme.



Ministri Demolli dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama zhvilluan takime të rëndësishme në Pentagon, Uashington DC dhe në shtetin Ajova

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Haki Demolli, së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë vizitës zyrtare në SHBA zhvilluan takime të
rëndësishme në Pentagon, Uashington DC dhe në shtetin e Ajovës me personalitete të larta shtetërore dhe ushtarake të SHBA-së, si me shefin e Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjeneralin Frank Grass, me gjenerallejtënant Keneth Mekenzi-shef i J-5–të të Komandës së Bashkuar të Ushtrisë së SHBA-së, me Guvernatorin e shtetit Aiova, Terry Branstad, komandantin e Gardës Kombëtare të Aiovës gjeneralin Timothy Orr, etj..
Në Pentagon ministri Demolli dhe gjeneral Rama u pritën zyrtarisht nga shefi i Gardës Kombëtare të SHBA-së, gjenerali Frank Grass, ku biseduan për marrëdhëniet Kosovë-SHBA në fushën e sigurisë, për procesin e transformimit të FSK-së, si dhe për çështje e tema të rëndësishme për sigurinë.
Ministri Demolli, nga ana e tij, e falënderoi gjeneralin Grass për bashkëpunimin e mirë ndërmjet dy vendeve dhe dy institucioneve dhe për mbështetjen e vazhdueshme që SHBA-të kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin për Kosovën dhe Forcën e Sigurisë në veçanti.
Ndërkaq, gjenerali Grass shprehu mbështetjen e institucioneve të Kosovës në krijimin e infrastrukturës që garanton një ambienti të qetë dhe të sigurt në Republikën e Kosovës.
Ndërsa, në Uashington DC gjenerali Keneth Mekenzi edhe një herë konfirmoi mbështetjen e SHBA-së për FSK-në. Ai po ashtu e përgëzoi gjeneral Ramën për pranimin e dy kadetëve të FSK-së në Akademinë Ushtarake në Uest Point (West Point), akademi kjo me traditë të gjatë mbi 200 vjeçare dhe më e njohura në botë.

Kongresi Amerikan përkrah Kosovën në Programin e Partneritetit për Paqe

Ministri i FSK-së z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 19 maj 2016, u pritën në një takim pune nga ambasadori i SHBA-ve z. Greg Delawie. Ministri Demolli e falënderoi ambasadorin Dellawie për ndihmën e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë dhe po japin për ngritjen profesionale të FSK-së, bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të Ajovës, si dhe për kërkesën e Kongresit Amerikan që të fillojnë përgatitjet që Kosova të hyjë në Programin e Partneritetit për Paqe (PfP), në kuadër të NATO-s.
Gjatë takimit, ministri Demolli dhe ambasadori Delawie biseduan edhe për zhvillimet e përgjithshme në Ministri, me theks të veçantë për procesin e transformimit të FSK-së.
Nga ana e tij, ambasadori Delawie shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin e deritashëm në mes dy shteteve si dhe të FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ai premtoi se SHBA-të do të vazhdojnë ta përkrahin procesin e transformimit të FSK-së dhe do ta ndihmojnë FSK-në edhe në të ardhmen.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s në Romë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama nga data 09-13 maj 2016 mori pjesë në kursin e lartë "Generals, Flag Officersand Ambassadors' Course", i cili u mbajt në Kolegjin e Mbrojtjes në Romë.
Qëllimi i këtij kursi ishte njoftimi rreth çështjeve aktuale politiko-ushtarake, shqetësimet që ndikojnë në Aleancë, si dhe rritja e mirëkuptimit të ndërsjellë për të promovuar rrjetin e bashkëpunimit mes gjeneralëve pjesëmarrës, oficerëve të lartë, ambasadorëve dhe civilëve me grada ekuivalente.
Programi i përgjithshëm i kursit i është dedikuar analizës dhe diskutimit të çështjeve kyçe dhe sfidave me të cilat përballet aktualisht Aleanca dhe si i zbaton NATO-ja rekomandimet nga Samiti i Uellsit dhe ai i Çikagos; konceptin strategjik të vitit 2010; rolin e saj operacional në Afganistan, në kuadër të misionit të Rezolutës për Mbështetje; si i monitoron nga afër zhvillimet në Ukrainë, Irak dhe Siri; si dhe përgatitjet për Samitin e ardhshëm të NATO-s në Varshavë.
Kursi ishte fokusuar në formësimin e nivelit strategjik, mjedisin e ardhshëm politik dhe strategjik, si dhe ndikimin e këtyre në NATO dhe tek politik-bërësit që kanë të bëjnë me NATO-n.
Pjesëmarrësit e kursit kanë përfituar nga sesionet pyetje-përgjigje dhe nga qasja e lirë e politikës akademike për të shfrytëzuar potencialin e plotë të ligjëruesve.
Gjeneral Rama gjatë këtij kursi të NATO-s zhvilloi takime edhe me gjeneralë dhe pjesëmarrës të tjerë të kursit.



Gjenerali amerikan Timothy Orr vizitoi njësitet e FSK-së

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës (SHBA), gjeneral majori Timothy Orr, nga data 29. 06 deri më datën 02. 07. 2016 së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, realizuan vizita pune në të gjitha njësitet e FSK-së.

Gjenerali Orr ishte pjesëmarrës i ceremonisë së diplomimit të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së më 1 korrik 2016 në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, ku përgëzoi kadetët për suksesin e treguar gjatë katër vjetëve të studimeve. "Kosova dhe Ajova janë krenare me ju. Për mua është nderë që gjendem prapë në Kosovë, në diplomimin tuaj. Tek Ju, unë shohë drejtues me integritet dhe shërbyes shembullor. Ju keni punuar shumë përgjatë katër vjetëve, që të arrini sot këtu dhe të merrni gradën e nëntogerit. Ju sot e keni bërë krenare tërë Kosovën. Ju jeni më të mirët e më të mirëve që ka Kosova. Para së gjithash mbani mend se, vendi juaj ka investuar kohë dhe para, që ju të arrini këtë pikë të karrierës ushtarake",- tha në fund të fjalës së tij gjenerali Orr.



Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr më pastaj vizitoi Komandën e Forcave Tokësore, Brigadën e Mbështetjes Operacionale, Regjimentin e Mbrojtjes Civile, Brigadën për Reagim të Shpejtë si dhe Batalionin e III-të dhe II-të të BRSH-së. Ai u prit nga stafi udhëheqës ku u njoftua me procedurat e udhëheqjes me njësitet, si dhe me rrjedhën e informacioneve të operacioneve të cilat i kryen Forca e Sigurisë së Kosovës.

Gjenerali Orr, gjatë vizitës së tij që i bëri Batalionit të III-të, përgëzoi toger Manushaqe Nurën për rezultatet e arritura në garat ndërkombëtare dhe tetar Rafet Gashin për garat vendore.

Komandant i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, e falënderoi gjeneralin Orr për ndihmën që Ushtria Amerikane ka dhënë dhe po jep për FSK-në në ngritjen e saj profesionale përmes trajnimeve dhe donacioneve të ndryshme, duke theksuar bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të Ajovës .

Në fund, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës përgëzoi komandantin e FSK-së, komandantët e njësiteve, oficerët dhe nënoficerët e FSK-së për arritjet e tyre profesionale, si dhe premtoi mbështetje në zhvillimin e liderëve të rinj me qëllim të ngritjes dhe mirëmbajtjes së kapaciteteve aktuale operacionale.

Ministri i FSK-së Haki Demolli priti drejtorin e Divizionit për Plane dhe Politika të NATO-s



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli, më 24 gusht 2016, priti një delegacion të NATO-s të kryesuar nga z. Paul Savereux, drejtor i Divizionit për Plane dhe Politika të Mbrojtjes së Aleancës. Ministri Demolli e falënderoi delegacionin e NATO-s për kontributin që po jep KFOR-i për sigurinë në vend dhe për punën e ekipeve këshilluese të NATO-s në MFSK dhe FSK.

Ministri Demolli e njoftoi

delegacionin e NATO-s edhe me objektivat e MFSK-së, me rekomandimet e dala nga Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë, me punën e Ministrisë rreth hartimit të amendamenteve kushtetuese, pakos së ligjeve dhe planifikimin afatgjatë në drejtim të përgatitjes sa më të mirë të procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Ai, veç tjerash, tha se: ,,Republika e Kosovës është e interesuar që ta thellojë bashkëpunimin me NATO-n", duke përmendur iniciativën e Qeverisë dhe Kryeministrit si dhe letrën që kryeministri Isa Mustafa i ka drejtuar NATO-s, si dhe anëtarësimin në iniciativa rajonale dhe me gjerë, ku përkrahja e partnerëve strategjikë si e SHBA-së, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, etj., ka qenë e duhura dhe se kjo pritet të zgjerohet edhe nga shtetet tjera në fushën e sigurisë në të ardhmen.

Ndërsa, komandanti i Forcë së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, e njoftoi delegacionin nga Brukseli me zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së, besueshmërinë e lartë që ka FSK-ja në opinionin vendor, si dhe rritjen e kësaj besueshmërie edhe tek minoritetet që jetojnë në Kosovë e posaçërisht tek pakica serbe. Ai e njoftoi edhe me pjesëmarrjen e FSK-së në trajnime dhe ushtrime jashtë vendit, si në rajon dhe më gjerë.

Nga ana e tij, drejtori i Divizionit për Politika dhe Plane në Aleancë z. Paul Savereux, tha se: NATO-ja është e përkushtuar për zhvillimin e Kosovës, ndërsa për sa i përket transformimit të FSK-së në FAK, tha se kjo varet nga shteti i Kosovës dhe se duhet të bëhet në përputhje me mundësitë dhe nevojat e Kosovës, pra për këtë proces dhe modalitetet e saj- vendos vetë Kosova.

NATO mandaton Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës për Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në



Në shtabin e KFOR-it në bazën Film City në Prishtinë, më 24 gusht 2016 u zhvillua ceremonia e ngritjes së Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë e FSK-së dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në aktin solemn të mandatimit të NALT-it për MFSK/FSK-në morën pjesë ministri i MFSK-së Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe stafi i lartë i MFSK/FSK-së. Ministri Demolli falënderoi NATO-n dhe KFOR-in për angazhimin e tyre në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend, e në veçanti falënderoi NATO-n për përkujdesjen ndaj ngritjes së institucioneve vendore të sigurisë në Republikën e Kosovës , si dhe për rolin-kontributin dhe rëndësinë e dy ekipeve këshilluese të NATO-s për Ministrinë dhe Forcën.

Ai tha se NAT/ NLAT që nga viti 2009 kanë pasur mision zhvillimin dhe profesionalizimin e Ministrisë dhe të FSK-së, kurse këshilltarët që kanë qenë, ata që janë këtu si dhe ata që do të vijnë pas jush, janë vlerë për MFSK/FSK-në, sepse doktrina dhe standardet e NATO-s janë vlera mbi të cilat Kosova do ta ndërtojë sistemin e mbrojtjes. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha se, vizioni dhe qëllimet tona të përbashkëta e bëjnë punën tonë mjaft të suksesshme dhe se ky koordinim e bashkëpunim do të jap frytet e veta në të ardhmen. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, për kontributin e tij në krye të ekipit të NLAT-it si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer me FSK-në, i dha gjeneral brigade Ernest Horn ,,Medaljen për Shërbim Vetëmohues". Në ceremoni folën edhe përfaqësuesit e NATO-s, z. Paul Savereux dhe Michel Soula, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Guglielmo Miglieta, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Ernest Horn, drejtori i NAT-it për MFSK-në zotëri Dominic Braithwaite.

Drejtor i ri i NALT-it, u emërua gjeneral brigade Dietmar Mosmann.





Komandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerali Hodges: FSK-ja e gatshme pret vendimin politik për transformim

Më 27 shtator 2106 komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në ambientet e Ministrisë ka pritur komandantin e Ushtrisë së SHBA-së për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges, të cilin e ka njoftuar me të arriturat e FSK-së dhe me zhvillimet rreth procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.
Gjenerali amerikan Hodges ka shprehur mbështetje për FSK-në në vizionin e saj, duke ofruar përkrahje për nevojat më specifike në rrugën e zhvillimit dhe profesionalizimit të mëtejshëm të FSK-së.
Për gjeneralin Hodges dhe delegacionin amerikan, nënkoloneli Agron Bajrami prezantoi temën: "FSK dhe procesi i transformimit të saj", ndërsa koloneli Ilir Qeriqi i informoi për bashkëpunimin ndërkombëtar me vendet tjera dhe partneritetin e ndërtuar deri më tani.
Më pas gjenerali Hodges së bashku me gjeneral Ramën vizituan Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së, ku gjenerali amerikan mbajti një ligjëratë dhe bashkëbisedojë me kadetët tanë.
Ai tha se talenti që ka parë tek pjesëtarët e FSK-së, e ka bërë që të jetë optimist për Kosovën, duke theksuar se FSK-ja do jetë ajo që do ta zhvillojë shtetin e Kosovës.
Ndërsa, në konferencën për media gjenerali Hodges tha se kadetët të cilët i ka takuar janë e ardhmja e Kosovës. "Dua që të shikoni prapa meje. Kjo është e ardhmja e Kosovës. Këta djem dhe vajza të jashtëzakonshëm këtu të cilët edhe pse kanë pasur zgjedhje të tjera kanë dalë vullnetarë për të kontribuar për vendin e tyre. Po ashtu mendoj që nën udhëheqjen e gjeneral Ramës dhe me këtë kapacitet që keni këtu, FSK-ja do ta zhvillojë Kosovën".
Ai u shpreh se: "Çfarë unë kam parë nga ushtarët e FSK-së është mbresëlënëse. Dje në Shqipëri në ushtrimet që i kemi bërë së bashku, kam parë ushtarë të rinj që janë të përgatitur dhe të motivuar. Mendoj që tashmë keni bërë disa aktivitete shpëtimi në Shqipëri, andaj tashmë ju keni marrë një vendim për transformimin, ta mbështes edhe Parlamenti".
Komandanti i Komandës së Ushtrisë së SHBA-ve për Evropë, gjeneral Hodges i shoqëruar nga gjeneral Rama kanë vizituar Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, ku nga komandanti i saj, kolonel Shaip Haziri janë njoftuar me misionin, detyrat dhe kapacitetet operacionale të njësive të specializuara si dhe rreth përgatitjeve për përurimin e Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të Regjimentit të Mbrojtjes Civile.
Në Qendrën e Kërkim-Shpëtimit Urban, vetë gjenerali Hodges mori rolin e një të aksidentuari, siç tha ai, për të provuar aftësitë dhe pajisjet e FSK-së "Unë i provova vet aftësitë dhe pajisjet tuaja duke pas besim në aftësitë tuaja, pajisjet dhe profesionalizmit tuaj", u shpreh ai.

Komandanti i FSK-së u prit në Romë nga shefi i Forcave të Armatosura të Italisë

Më 26 shtator 2016 komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të shefit të Forcave të Armatosura të Italisë gjenerallejtënant Danilo Errico qëndroi për vizitë zyrtare në Romë. Në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Italisë, gjeneral Rama u prit nga gjenerallejtënant Danilo Errico, ku gjatë takimit biseduan për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve në fushën e sigurisë, si dhe për bashkëpunimin mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Italisë.
Gjeneral Rama e ka falënderuar gjeneralin Errico për kontributin që Forcat e Armatosura të Italisë po japin për sigurinë dhe paqen në Kosovë, e në veçanti për kontributin e tyre në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së.
Ai e njoftoi gjeneralin Errico edhe me zhvillimin e FSK-së, pjesëmarrjen në stërvitje të përbashkëta, si dhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës.
Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjithashtu e ka



njoftuar gjeneralin Errico për nivelin e sigurisë në Kosovë, si dhe për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shumë vende në këtë fushë, duke shprehur dëshirën par nënshkrimin e nja marrëveshjeje të tillë edhe me Italinë.
Nga ana e tij, shefi i Forcave të Armatosura të Italisë, gjenerali Danilo Errico u shpreh i gatshëm për vazhdimin e bashkëpunimit dhe intensifikimin e tij në të ardhmen.

Ushtarakë të Gardës Kombëtare të Ajovës vizituan MFSK-në dhe KFT-në

Një delegacion prej 61 ushtarakësh të rangjeve të ndryshme të Gardës Kombëtare të Ajovës nga SHBA-të, më 13 shtator 2016 vizituan Ministrinë për Forcën e Sigurisë dhe Komandën e Forcave Tokësore. Vizita e ushtarakëve amerikanë ka për qëllim forcimin e partneritetit strategjik dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, si dhe zgjerimin e njohurive të ushtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Flotës Ajrore lidhur me historinë e Republikës së Kosovës.
Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pasi qe iu dëshiruari mirëseardhje ushtarakëve amerikanë, shtoi: "Kjo vizitë është e mirëseardhur dhe do të ndikojë në njohjen tonë reciproke dhe në forcimin e marrëdhënieve tona dypalëshe dhe të partneritetit me Ajovën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjeneral Rama i njoftoi ushtarakët amerikanë me zhvillimet e përgjithshme në FSK, e në veçanti me zhvillimet rreth procesit të transformimit të FSK-së .
Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, falënderoi delegacionin e ushtarakëve amerikanë për vizitën dhe përmes tyre Gardën Kombëtare të Ajovës, SHBA-të dhe Komandën e Ushtrisë Amerikane për Evropë për mbështetjen e tyre të pakursyer karshi Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe Republikës së Kosovës në përgjithësi.
Delegacioni i ushtarakëve amerikanë të shoqëruar nga gjeneral brigade Enver Cikaqi- komandant i KDS-së, realizuan vizita pune në Komandën e Forcave Tokësore dhe në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së në Prishtinë. Delegacioni i Gardës Kombëtare të Ajovës gjatë qëndrimit në Kosovë vizitoi qytetin e Prizrenit, Batalionin e Tretë të Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë dhe shumë vende me rëndësi kulturore dhe historike.

Ministri Haki Demolli takoi gjeneralët amerikan Altman dhe De Haes nga Garda Kombëtare e Ajovës

Më 13 shtator 2016 ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës(MFSK), Haki Demolli priti në takim gjeneralët Steven Altman dhe William De Haes nga Garda Kombëtare e Ajovës, të cilët i falënderoi për mbështetjen që Garda Kombëtare e Ajovës po jep për FSK-në. Më këtë rast, ministri Demolli i njoftoi gjeneralët Altman dhe DeHaes me zhvillimet në FSK, marrëdhëniet e saj me partnerët dhe procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.
Gjatë takimit ministri Demolli vlerësoi se, mbështetja e SHBA-së si partner strategjik i Republikës së Kosovës dhe i MFSK-së është mjaft e rëndësishme edhe në të ardhmen,
sidomos në drejtim të ngritjes dhe forcimit të institucioneve të sigurisë në vend.
Takimi i ministrit me gjeneralët amerikanë u zhvillua në kuadër të vizitës së një delegacioni prej 61 ushtarakësh të rangjeve të ndryshme nga Garda Kombëtare e shtetit të Ajovës.
Vizita e delegacionit të ushtarakëve amerikanë ka për qëllim forcimin e partneritetit strategjik, rritjen e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, si dhe zgjerimin e njohurive të ushtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Flotës Ajrore amerikane për historinë e Republikës së Kosovës.



U mbajt konferenca e 5-të "FSK dhe Partnerët"

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), më 28 tetor 2016, u mbajt konferenca e dytë vjetore "FSK dhe partnerët" në organizimin e Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri të MFSK-së.

Në fjalën e hapjes, ministri i FSK-së, Haki Demolli, tha se, Ministria e Forcës së Sigurisë dhe FSK-ja objektiv primar kanë intensifikimin e bashkëpunimit me partnerët, ku përmes të cilit shtetet mike të Republikës së Kosovës po ofrojnë mbështetje në forma të ndryshme në ngritjen e kapaciteteve tona. Takimet e këtilla, si kjo konferencë, apo ushtrimet e përbashkëta siç ishte ushtrimi i djeshëm fushor "Shqiponja V", ku pjesëmarrës të planifikimit dhe realizimit të tij ishin edhe ushtarët dhe oficerët e Ushtrisë Amerikane dhe pjesëtarët e KFOR-it, ndërsa shumë ushtarakë të shteteve mike ishin në cilësinë e vëzhguesve, po ndikojnë jo vetëm në rritjen e ndërveprimit ndërmjet nesh, por edhe në rritjen e mundësive për zhvillimin e trajnimeve të mirëfillta në përputhje me standardet veri-atlantike, e të cilat janë synim final i FSK-së dhe Republikës së Kosovës në tërësi.



Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha se, FSK-ja që nga themelimi i saj është përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve si në personel ashtu edhe në infrastrukturë, në pajisje dhe në krijimin e kushteve sa më të mira për pjesëtarët tanë. Ai, duke iu drejtuar pjesëmarrësve tha: "Ju keni një rol kyç në këtë drejtim, sepse gjithçka që kemi bërë deri tani ishte në partneritet me ju dhe bazuar në standardet e NATO-s, dhe vazhdimi i këtij bashkëpunimi të shkëlqyeshëm është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të FSK-së, si një institucion për të mirën e vendit dhe kontribuuese e sigurisë".

Me nga një fjalë rasti në konferencë u paraqitën edhe zv. komandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Riener, gjenerali nga Garda Kombëtare e Ajovës, Steven Altman dhe gjeneral Mosmman, drejtor i NLAT-it.

Punimet e konferencës "FSK dhe partnerët" i kryesoi, kolonel Ilir Qeriqi, ndërsa drejtorët, shefat dhe oficerët e departamenteve të MFSK-së prezantuan objektivat e zhvillimit si dhe paraqiten sfidat dhe nevojat për të ardhmen.

Gjithashtu edhe atashetë e Mbrojtjes të vendeve partnere nga: SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Shqipëria, Kroacia, Hungaria, Italia, Gjermania, Holanda, Maqedonia dhe Japonia prezantuan kapacitetet dhe ofertat për mbështetje në fushat me interes për FSK-në për periudhën e ardhshme, si dhe diskutuan për aktivitetet në kuadër të planeve të bashkëpunimit dypalësh në të ardhmen.

Qëllimi i konferencës ishte rritja e ndërsjellë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes FSK-së, vendeve partnere, Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATOS për MFSK-në dhe FSK-në, përfaqësuesve të institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës nga fusha e sigurisë dhe diplomacisë, më qëllim të qasjes gjithëpërfshirëse të institucioneve relevante për sinkronizimin dhe ndërveprimin në mes institucioneve tona në të mirë të zhvillimit të kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.



Ministri Haki Demolli priti zv. asistentin për operacione të Sekretarit gjeneral të NATO-s John Manza



Ministri i Ministrisë për FSK-në z. Haki Demolli më 6. 10. 2016 priti në një takim zyrtar zv. asistentin për operacione të Sekretarit gjeneral të NATO-s, z. John Manza, të cilin e njoftoi për bashkëpunim me NALT-it në MFSK dhe FSK. Ai, tha se këshillimi dhe koordinimi me mekanizmat e NATO-s na ndihmon në zhvillimin e FSK-së, me standarde që do të mundësojnë ndërveprueshmëri, si dhe do të përgatisë institucionet tona të sigurisë për anëtarësim në mekanizma ndërkombëtarë; iniciativa rajonale dhe globale dhe në Aleancën Veri-Atlantike. Kurse për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, ministri Demolli, tha se i tërë procesi është transparent për institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. Kjo Forcë do të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, e cila do të kontribuojë për paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë.

Nga ana e tij, z. John Manza konfirmoi se NATO me vëmendje po përcjell zhvillimin e FSK-së dhe është duke shqyrtuar letrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ku së shpejti do të del me një përgjigje. "Strategjia juaj që përmes pjesëmarrjes në operacione stërvitore të përbashkëta, si në Kosovë ashtu edhe në vendet partnere, është strategji shumë e mirë dhe ju garantoj në mbështetjen e strategjisë së FSK-së, që përmes stërvitjeve të përbashkëta me vendet e NATO-s, vendet partnere të dëshmojë për aftësitë e saja ndërve pruese",tha në fund zëvendës asistenti për operacione i Sekretarit gjeneral të NATO-s z. John Manza.



Gjenerallejtënant Rrahman Rama pjesë e konferencës ushtarake në SHBA

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama nga data 1 e deri më 5 tetor 2016 mori pjesë në konferencën vjetore të Shoqatës të Ushtrisë Amerikane, e cila u mbajt në Uashington të SHBA-ve. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama gjatë vizitës në SHBA është pritur nga komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majori Thimoty Orr, me të cilin kanë biseduar rreth vazhdimit të bashkëpunimit të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Gjeneral Rama po ashtu është takuar edhe me shumë personalitete të larta ushtarake pjesëmarrëse në konferencë dhe në panairin e armëve dhe sistemeve mbrojtëse.

FSK-ja pjesëmarrëse në samitin e grave lidere të organizuar nga Garda Kombëtare e Ajovës-SHBA



Një delegacionin i MFSK/FSK-së, më 7 tetor 2016, i udhëhequr nga kolonel Irfete Spahiu, zëvendëskomandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe në shoqërim të oficerit për marrëdhënie dypalëshe pranë Ambasadës së SHBA-ve, major Jodie Marti, qëndruan për një vizitë zyrtare një javore në shtetin e Ajovës-SHBA. Qëllimi i vizitës së delegacionit të MFSK/FSK-së, ishte pjesëmarrja në samitin e grave lidere të organizuar nga Garda Kombëtare e Ajovës.

Manifestime dhe homazhe: FSK-ja parakaloi në 8- vjetorin e Pavarësisë



Ministri i FSK-së Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtënantë Rrahman Rama dhe stafin e lartë të Ministrisë dhe FSK-së, shënimin e 8-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës e nisen me homazhe në Memorialin e Komandantit Legjendar Adem Jashari në Prekaz, të cilët në shenjë nderimi vendosën kurora me lule të freskëta dhe bënë homazhe.
Manifestimi qendror për shënimin e përvjetorit të pavarësisë u mbajt në sheshet "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti". "Kjo është dita më e shënuar e historisë së Kosovës që përmbledh sakrificën, mençurinë e përkushtimin për ta jetësuar idealin e gjeneratave të tëra për një shtet" tha në fillim të fjalës së saj, presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, për të shtuar se: "Tetë vjet që prej shpalljes së pavarësisë ne përkujtojmë idealet që na bëjnë bashkë, përkushtimin për lirinë dhe për zhvillimin e vendit tonë, për demokracinë që ndërtohet çdo ditë dhe njëkohësisht edhe për paqen".



Presidentja Jahjaga përshëndeti edhe FSK-në për punën që po bën në ndërtimin e një force të re. "Sot është festë për ju pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që keni përmbledhur me sukses prej shumë muajsh punën tuaj në ndërtimin e një force të re mbrojtëse e që po prisni, ashtu si edhe të gjithë qytetarët e tjerë, ta realizoni ëndrrën tuaj. Forca e Armatosur e Kosovës është e ardhmja e juaj, e ardhmja jonë e përbashkët, e ardhmja e shtetit të Kosovës".
Në fund, presidentja e Kosovës vlerësoi se Pavarësia e Kosovës është garantuese e paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajonin e Evropës Juglindore. Ndërsa kryeministri i Kosovës Isa Mustafa, në fjalën e tij, në përvjetorin e shënimit të 8- vjetorit të Pavarësisë së Kosovës përmblodhi të arriturat e përgjithshme të Republikës së Kosovës. "Kjo ditë është kurorëzim i aspiratës për liri, pavarësi dhe demokraci, është ditë e përkujtimit të sakrificës së shumë
gjeneratave që u flijuan për këtë ide dhe dëshmorëve e martirëve të vendit të bekuar. Këto 8 vjet, ne kemi demonstruar përkushtim për ta bërë Kosovën një vend të denjë për të jetuar. Kemi dëshmuar përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe jemi përpjekur të njohim e zbatojmë obligimet tona ndaj fqinjëve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Në FSK u mbajt manifestimi qendror “Epopeja e UÇK-së”

Manifestimi qendror në kuadër të shënimit të "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", nën mbikëqyrjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, u mbajt në kazermën ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Prishtinë.
Për nderë të shënimit të 18-vjetorit të rënies së Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari si edhe të gjithë të rënëve për liri dhe pavarësi, para kuadrateve të rreshtuara parakaluan presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga dhe komandanti i Forcës së Sigurisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Pas intonimit të dy himneve, himnit shtetëror dhe himnit kombëtar, udhëheqja me e lartë e shtetit; presidentja Atifete Jahjaga, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Isa Mustafa, ministri i FSK-së Haki Demolli dhe komandanti i Forcë së Sigurisë gjenerallejtënant Rrahman Rama, vendosën kurorë lulesh tek Obelisku i dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare dhe dëshmorëve të të gjithë brezave.
Me këtë rast, kryetarja e shtetit, zonja Jahjaga tha: ,,5 Marsi është dita më e shënuar e historisë së Kosovës që përmbledh

sakrificën, mençurinë e përkushtimin për ta jetësuar idealin e gjeneratave të tëra për një shtet, pra kjo është dita e Kosovës-dita kur kremtojmë lirinë, një lindje të re për qytetarët e shtetit të ngritur mbi themelin e barazisë".
Më tej, Jahjaga shtoi: „Kosova është një realitet i pakthyeshëm; një paqe e fituar pas një lufte të gjatë e të rëndë; një liri për të cilën është sakrifikuar; një miqësi e përjetshme me SHBA-në që ka qëndruar kaq pranë nesh në secilin kapitull të shtet-ndërtimit tonë. Kosova është vlera e shtuar e stabilitetit dhe sigurisë jo vetëm në rajon, një forcë e pazëvendësueshme e fqinjë-sisë, garantuese e paqes për të gjithë, që hap rrugën e integrimeve".
Në fund të fjalës së saj presidentja Jahjaga tha: „Sot është festë për ju pjesë- tarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që keni përmbledhur me sukses prej shumë muajsh punën tuaj në ndërtimin e një force të re mbrojtëse e që po prisni, ashtu si edhe të gjithë qytetarët e tjerë, ta realizoni ëndrrën tuaj. Forca e Armatosur e Kosovës është e ardhmja e juaj, e ardhmja jonë e përbashkët, e ardhmja e shtetit të Kosovës!".
Në nderim të Epopesë së UÇK-së, me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, i cili para kuadrateve dhe forcave që Ai drejton si dhe para udhëheqësve institucionalë e shtetërorë mbajti një fjalë rasti. Gjeneral Rama ndër të tjera tha :„Duke mësuar nga e kaluara dhe duke mësuar nga shembujt e botës demokratike, të ndjekim traditën, "Nderojmë të kaluarën dhe ndërtojmë të ardhmen". Me këtë moto, tha komandanti i FSK-së, Forca e Sigurisë së Kosovës është duke punuar që të ndërtojë një forcë profesionale, në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj. Kjo Forcë „do të ndërtohet mbi vlerat tona kombëtare, dhe vlerat euroatlantike e perëndimore. Kjo forcë do të jetë e ndërveprueshme me gjithë partnerët tanë, dhe e gatshme që t'iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës".
Në fund, gjeneral Rama tha: „Është në duar tona që amanetin e të rënëve të shtyjmë përpara me përkushtim, se vetëm kështu nderojmë gjakun e derdhur dhe nderojmë të rënët me gjenerata të tëra", duke thirrur për lavdi siç tha Ai, „Lavdi Familjes Jashari; Komandantit legjendar Adem Jashari; dëshmorëve të UÇK-së dhe gjithë dëshmorëve të kombit. Manifestimin e nderoi edhe përfaqësuesi i familjes Jashari, vëllai i Komandantit legjendar Adem Jashari, zotëri Rifat Jashari i cili ndër të tjera u shpreh se: „duhet të jemi syçelë në mënyrë që ta ruajmë gjakun e bijve dhe bijave tona, ta qojmë përpara amanetin për të cilin ranë dëshmorët e kombit të të gjithë brezave".






Drejtusit e FSK-së homazhe në Memorialin e Reçakut

Me rastin e 17-vjetorit të Masakrës së Reçakut, të kryer nga forcat ushtarake okupuese serbe ndaj civilëve shqiptarë, për vizitë ishte një delegacion i Ministrisë së FSK-së dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) i kryesuar nga ministri Haki Demolli e ku merrnin pjesë zëvendësministrat: Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së z. Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Bashkim Jashari, Nazmi Brahimaj, Gëzim Hazrolli, zyrtarë dhe oficerë tjerë të lartë të FSK-së.



Me këtë rast, ministri Demolli dhe gjeneral Rama në Memorialin e Reçakut në shenjë nderimi për të rënët vendosen lule të freskëta.
Ministri Demolli vizitoi edhe varrezat e martirëve, ku takoi edhe familjarët e të rënëve në Reçak, të cilët i ngushëllojë duke shprehur njëkohësisht krenarinë për ta. "Gjaku i martirëve të Reçakut së bashku me gjakun e gjithë dëshmorëve të rënë u bë themel i Lirisë dhe Shtetit të Pavarur të Kosovës".

Ministri dhe komandanti i FSK-së nderuan dëshmorët e UÇK-së në "Epopenë e Dukagjinit"

Në kuadër të manifestimit "Epopeja e Dukagjinit" më 24 mars 2016, ministri i FSK-së Haki Demolli, zëvendësministri Fadil Gashi, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku edhe me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë z. Qemal Minxhozi, të shoqëruar edhe nga gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli si dhe oficerë të tjerë të lartë të FSK-së, bënë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Gllogjan, duke vendosur buqeta me lule, në nderim të dëshmorëve të rënë në luftën çlirimtare të UÇK-së.



Delegacioni i FSK-së me në krye ministrin Demolli, pas homazheve bënë vizitë në familjen Haradinaj ku u pritën ngrohtësisht nga kryefamiljari Hilmi Haradinaj.
Me këtë rast ministri Demolli shprehu mirënjohjen dhe respektin e thellë për sakrificën e madhe të familjes Haradinaj, të luftëtarëve të Dukagjinit dhe gjithë dëshmorëve të UÇK-së. Ai shprehu besimin e thellë se Kosova dhe populli i saj do të jenë gjithmonë mirënjohës për sakrificën e bërë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së bënë homazhe në "Varrezat e Dëshmorëve" në Koshare

Ministri i FSK-së Haki Demolli dhe komandanti gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me zëvendësministrin Fadil Gashi, gjeneralët e brigadës Nazmi Brahimaj dhe Gëzim Hazrolli, si dhe zyrtarë dhe oficerë të lartë të Ministrisë dhe FSK-së, më 9 prill 2016, morën pjesë në shënimin e përvjetorit të 17-të të manifestimit "Ditët e Shqipes" të Betejës së Lavdishme të UÇK-së në Koshare. Demolli dhe Rama në varrezat e dëshmorëve të Brigadës 138 "Agim Ramadani" bënë homazhe dhe në nderim të dëshmorëve të kësaj Brigade vendosën kurora me lule të freskëta, si dhe takuan familjarët e dëshmorëve të cilëve u shprehën ngushëllimet dhe krenarinë e tyre për heroizmin e bijve dhe bijave të tyre, në luftën e shenjtë që bënë për thyerjen e kufirit Kosovë-Shqipëri. Gjithashtu, ministri dhe komandanti së bashku me delegacionin e MFSK-së, përcollën edhe manifestimin "Ditët e shqipes" organizuar nën patronatin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Isa Mustafa.

FSK-ja përfundoi me sukses operacionet e deminimit humanitar për vitin 2016

Deminerët e FSK-së që nga viti 2010, kanë pastruar mbi 11.720.042 metra katror dhe kanë shkatërruar mbi 2177 mjete eksplozive të pashpërthyera.



Gjatë vitit **2016**, njësitë e FSK kanë zhvilluar operacione të deminimit në pesë lokacione ku kanë arritur të pastrojnë 221,790 metra katrorë, janë gjetur **72** mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera. Po ashtu njësitë kujdestare të EOD/FSK kanë intervenuar në **276** raste dhe kanë demoluar **336** mjete të ndryshme eksplozive. Përveç njësive që zhvillojnë operacionet e deminimit humanitar FSK ka edhe dy njësi kujdestare 24/7 për intervenime në rastet kur qytetarët hasin në mjete të ndryshme eksplozive dhe lajmërojnë për largimin e tyre. FSK ka filluar zhvillimin e operacioneve të EOD-së që nga data **30 Gusht 2010** ku është filluar kujdestaria me dy ekipe kujdestare njëra në Prizren dhe tjetra në Pomozotin 24/7.

Që nga fillimi i këtyre operacioneve FSK ka intervenuar në **2039** raste dhe ka demoluar **3050** mjete të ndryshme eksplozive. Në tersi që nga viti **1999** janë pastruar **50,028, 463** metra katrorë, janë gjetur **88,730 mina** dhe mjete eksplozive të pashpërthyera nga të gjitha organizatat e përfshira në pastrimin e minave dhe mjeteve eksplozive të pashpërthyera. Njësitë e deminimit të FSK-së janë duke rivendosur dhe krijuar një mjedis të sigurt në fushat e tanishme të rrezikuara, duke mundësuar zhvillimin e jetës normale. Këto rezultate na bëjnë krenarë për punën e shkëlqyer që është kryer nga FSK, ku me veprimet e FSK-së janë shpëtuar shumë jetë njerëzish dhe njëkohësisht është kthyer një numër i madh i tokave komuniteteve të ndryshme për shfrytëzimin e tyre.

Pjesëtarët e FSK-së dhuruan mbi 1200 doza gjak për qytetarët e Kosovës

Pjesëtarët e Ministrisë se Forcës së Sigurisë dhe të të gjitha njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), përfunduan aksioni humanitar për dhurimin e gjakut me moton "Një pikë gjak për shpëtimin e një jete".

Aksioni u organizua nga Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Departamenti i Mjekësisë i MFSK-së, dhe u realizua nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës dhe Kompania e Mjekësisë e FSK-së. Ministria dhe FSK-ja kanë traditë në organizimin e dhurimit humanitar të gjakut. Vetëm gjatë aksionit të parë, për këtë vit, janë mbledhur mbi 1200 doza gjak, të cilat do të jenë në shërbim të të gjithë qytetarëve të cilët kanë nevojë për të. Pjesëtarët e FSK-së, me këtë aksion kanë dhënë shembullin më të mirë në ndihmë të qytetarëve, i cili padyshim ka ndikuar edhe në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për t'iu përgjigjur aksioneve të ndryshme humanitare dhe iniciativave të tilla siç ishte edhe kjo.



Dr. Bahrije HaliliGjocaj, udhëheqësja e këtij aksioni humanitar u shpreh se pjesëtarët e FSK-së janë shembull për dhurimin vullnetar të gjakut. Ata janë donatorë të rregullt që gjithherë me vullnet i janë përgjigjur këtij aksioni, jo vetëm gjatë organizimeve të rregullta por edhe jashtë tyre. Ndërsa, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në MFSK, Harjush Kurtaj, falënderoi pjesëtarët e FSK-së për gatishmërinë e treguar gjatë këtij aksioni dhe për ndihmën e tyre të vazhdueshme në shërbim të qytetarëve të Kosovës. FSK-ja tashmë ka bërë traditë organizimin e aksioneve për dhurimin e gjakut në nivel vendi, duke qenë njëherësh edhe donatori kryesor i saj, ku brenda vitit janë dhuruar mbi 1240 doza gjak për nevojat e QKTGJK.

FSK-ja në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën"



Pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe udhëheqës të saj më 24 maj u bënë pjesë e një aksioni të organizuar në nivel vendi, me moton "Ta pastrojmë Kosovën". Me këtë rast, gjeneral Halimi përshëndeti pjesëmarrësit e aksionit për pastrimin e ambientit, nxënësit e shkollave fillore, ushtarët e FSK-së dhe qytetarët e Kosovës. Ai, ndër të tjera tha: "Këtë aktivitet e kemi bërë tashmë tradicional në gjithë Kosovën. Sot, po marrim pjesë dhe po kontribuojmë në pastrimin e ambientit sepse është në të mirën e fëmijëve dhe qytetarëve tanë. FSK-ja si zakonisht ka përkrahur dhe do të përkrahë aksionet e tilla, që janë në dobi të Kosovës.

Ndërsa, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Ferid Agani, pasi që falënderoi FSK-në për përkrahjen e aksionit me ushtarë dhe makineri të rëndë, është shprehur. "Kjo sot që po e shohim është një dëshmi e fuqisë së qytetarisë së Kosovës, që tregon se edhe ne jemi pjesë e Evropës, duke treguar një përkushtim të madh për mjedisin dhe kjo më bënë shumë optimist që në ditët e ardhshme do ta kemi shtetin tonë ashtu siç jemi vetë".

Ish presidentja Kosovës, znj. Atifete Jahjaga mori pjesë në aksionin për pastrimin e mjedisit dhe njëherësh u bëri thirrje qytetarëve që të kujdesen për ruajtjen e mjedisit. Kurse, koordinatori i Iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën", Luan Hasanaj, falënderoi qytetarët dhe në veçanti Forcën e Sigurisë së Kosovës për përkrahje të vazhdueshme dhe ndihmën e saj me makineri të rëndë. FSK-ja në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", ka pastruar dhe larguar nga deponitë ilegale qindra tonë mbeturina.

Ky aksion ka filluar në lagjen Kalabria në Prishtinë, ku morën pjesë, gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel Naim Haziri, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferid Agani, ish-presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, përfaqësues dhe vullnetarë të iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën", nxënës të shkollave fillore të Prishtinës, si dhe vullnetarë e qytetarët të tjerë.

FSK-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Tokës

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës, më 22 prill, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe FSK-ja organizuan aktivitete të ndryshme si pastrimin e hapësirave të gjelbra, mbjelljen e fidanëve, drurëve dekorativ dhe luleve në mjediset e Ministrisë dhe kazermave të FSK-së, si dhe pastrimin e disa hapësirave publike. Aktiviteti kryesor u mbajt në mjediset e MFSK-së dhe në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Aksionin për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës e përshëndeti zëvendësministri Fadil Gashi, i cili falënderoi të gjithë pjesë marrësit të cilët pastruan mjediset përreth Ministrisë dhe FSK-së. Ai njëherësh kërkoi nga të pranishmit që për mjedisin të kujdesemi çdo ditë, në mënyrë që të rrisim kualitetin e jetës në mjediset ku jetojmë dhe punojmë. Ky aksion u shënua në të gjitha kazermat e FSK-së.



Aksionit për pastrimin dhe mbjelljen e fidanëve në Ministri dhe FSK iu bashkuan zëvendësministrat Fadil Gashi dhe Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, gjeneralët Zymer Halimi, Nazmi Brahimaj dhe Gëzim Hazrolli, oficerë dhe ushtarë të FSK-së, si dhe safi civil i Ministrisë edhe pjesëtarët e NAT-it, NLAT-it (Ekipi Këshillues dhe Ekipi Ndërlidhës i NATO-s për FSK-në). Po ashtu në kuadër të bashkëpunimit Civilo-Ushtarak, FSK-ja me rastin e Ditës së Tokës ka qenë e angazhuar me mjetet teknike dhe personel në pastrimin e hapësirave në lagjet „Emshir" dhe "Hajvali", ku në Hajvali ka pastruar mjediset e gjelbra përreth Pallatit të Drejtësisë .

FSK-ja më e besueshmja në Republikën e Kosovës

Forca e Sigurisë së Kosovës është ndër institucionet më të besueshme në vend sipas të gjitha hulumtimeve dhe anketimeve në pesë vitet e kaluara, duke lenë pas kështu vazhdimisht të gjitha institucionet tjera të sigurisë në nivel vendi.
Sipas të dhënave të publikuara më 13 prill, nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), me temën: "Monitorimi i Sektorit të Sigurisë së Kosovës, nëntor 2015-mars 2016".
Rritjen më të madhe të besueshmërisë nga të gjithë udhëheqësit në sektorin e sigurisë e ka shënuar ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli në shkallë 3.00 për qind. Në bazë të analizës së rezultateve të hulumtimit ka dalë se FSK-ja prin me besueshmëri nga ana e qytetarëve me 3.69 për qind. Në tri anketa të zhvilluara me qytetarët e Kosovës, nga Barometri i Kosovës për Siguri, Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest dhe Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) rezulton se FSK-ja dhe Ministria e FSK-së janë më të besueshmet për qytetarët e Kosovës me mbi 67%. Sipas këtij hulumtimi Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës për qytetarët e Kosovës është institucioni më i besueshëm në Kosovë.
Ndërsa, sipas rezultateve të Barometrit të Kosovës për Siguri të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë në Prishtinë, 88% e qytetarëve të vendit të anketuar kërkojnë që FSK-ja të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës. Forca e Sigurisë së Kosovës(FSK) tanimë ka rritje të besueshmërisë edhe nga minoriteti serb që jeton në Republikën e Kosovës. Kjo u bë e ditur më 15 gusht 2016, në promovimin e numrit të katërt të vëllimit të parë të Opserverit të Sektorit të Sigurisë së Kosovës të zhvilluar nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave(KIPRED).

Kadetët e FSK-së për dy javë realizuan ushtrimin fushor "Kampi veror 2016" në Zhegoc të Gjilanit

Qendra e Studimeve Universitare(QSU) e Forcës së Sigurisë të Kosovës më 17 qershor 201, realizoi me sukses ushtrimin fushor "Kampi veror 2016" në Zhegoc të Gjilanit.
"Qëllimi i mbajtjes të ushtrimit fushor "Kampi veror 2016" është vlerësimi i kadetëve për shkencat ushtarake për vitin 2015-2016" tha komandanti i saj, major Avni Kiqina, i cili i njoftoi të pranishmit me ecurinë e zhvillimit të ushtrimit fushor në këtë kamp.
Pas demonstrimit të kadetëve të FSK-së, zëvendës komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i përgëzoi kadetët për angazhimin dhe paraqitjen e shkëlqyeshme gjatë ushtrimit. " Ju duhet t'i realizoni synimet të cilat i keni para vetës në krijimin e liderëve me vetiniciativë, andaj kërkoj nga ju që të shfrytëzoni këtë mundësi të mirë, për të përfituar nga eksperiencat e mëdha të mbështetësve tanë nga Brigada Shumëkombëshe Jug, si dhe nga oficerët tanë më përvojë disavjeçare para dhe pas lufte. Ne si institucion i vogël që jemi, vetëm më vlera mund të konkurrojmë dhe të jemi përkrah aleatëve tanë", tha në fund gjeneral Hazrolli.
Të pranishëm gjatë demonstrimit të kadetëve ishin edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Irfete Spahiu, drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s për FSK-në(NLAT), gjeneral brigade Ernst Horn, komandanti i kampit „Bondstell", kolonel Gammom, etj.

Kadetët e FSK-së dallohen me paraqitjen e suksesshme gjatë operacioneve në “Kampin veror 2016” në Krivollak të Maqedonisë

Ushtrimi fushor "Kampi veror 2016" (13.07.2016) u organizua nga Ministria e Mbrojtjes dhe Akademia Ushtarake e Maqedonisë dhe kishte karakter ndërkombëtar, ku për çdo vit marrin pjesë kadetët e vendeve të ndryshme të rajonit, të menaxhuar nga instruktorë të NATO-s dhe të Partneritetit për Paqe (PpP).
Këtë vit, krahas kadetëve të 13 shteteve, morën pjesë edhe kadetët e FSK-së, të cilët u dalluan me demonstrimin e suksesshëm dhe profesional gjatë 12 ditëve të ushtrimit në "Kampin veror 2016", në Krivollak të Maqedonisë.
Kadetët, ushtarët dhe eprorët pjesëmarrës në ushtrim treguan një nivel të lartë të angazhimit, veprimit dhe koordinimit në mes tyre, duke vepruar si njësi unike në realizimin e detyrave të përcaktuara sipas skenarit të ushtrimit. Kadetët e të gjitha



vendeve pjesëmarrëse, gjatë demonstrimit e përbënë një batalion shumëkombësh të ngarkuar me detyra të operimit dhe realizimit në terren.
Për të përcjellë demonstrimin e kadetëve gjatë ushtrimin fushor, kishin ardhur edhe shumë zyrtarë dhe oficerë të lartë nga ushtritë e shteteve pjesëmarrëse.
"Është hera e parë që sivjet ka kaq numër të madh pjesëmarrësish, të cilët na treguan neve, se si liderët e ardhshëm të vendeve të tyre, por edhe studentët mund të flasin një gjuhë të përbashkët, dhe mund të bashkëpunojnë për një të ardhme më të mirë të vendeve të tyre" tha pos tjerash, zëvendësministri i Mbrojtjes i Maqedonisë z. Bekim Maksuti.
Kurse, drejtori i Drejtorisë për Operacione dhe Trajnime në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi, shtoi se: "Që nga viti 2010, ky kamp është bërë tradicional dhe është shumë i rëndësishëm për ne, pasi që kadetët e FSK-së, kanë mundësi të shkëmbejnë eksperienca me kadetët pjesëmarrës në ushtrim, - tha në fund gjeneral Halimi.
Kadetët e FSK-së edhe këtë vit u dalluan me paraqitjen e tyre të shkëlqyeshme si në operacionet individuale ashtu edhe kolektive.

FSK-ja në stërvitjen e përbashkët "Joint Effort-1" në Shqipëri

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, vlerësoi lartë pjesëmarrjen e Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së në stërvitjen "Joint Effort-16". FSK-ja demonstroi profesionalizëm të lartë, përkushtim, motivim dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm me ushtritë pjesëmarrëse në stërvitjen "Joint Effort -16", shtoi në fund gjeneral Rama.
Batalioni i Dytë i Brigadës për Reagim të Shpejtë i FSK-së mori pjesë në stërvitjen ndërkombëtare "Joint Effort-16",të organizuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës Shqipërisë dhe njësitet ushtarake të Forcave të Armatosura të SHBA-ve, Britanisë së Madhe, Italisë, FSK-së dhe Malit të Zi, mbajtur në Bizë- Shqipëri.
Në stërvitjen e përbashkët "Joint Effort-16" morën pjesë mbi 1500 trupa, dhe është njëra ndër stërvitjet e përbashkëta më të mëdha që FA kanë zhvilluar me NATO-n, në dhjetë vitet e fundit në Shqipëri.
Qëllimi i zhvillimit të stërvitjes ushtarake "Joint Effort-16" ishte rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave pjesëmarrëse dhe kapaciteteve operacionale të shtabeve dhe njësive të FA në procesin e planëzimit dhe ekzekutimit të operacioneve luftarake në mjedis të përbashkët (JOINT) dhe multinacional, në nivel taktik dhe operativ.
Ministrja e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, në ,Ditën e Vizitorëve të Shquar, tha: "Stërvitja "Joint Effort - 2016" është një mundësi e mirë jo vetëm për përmirësimin e aftësive të mirëfillta ushtarake, por edhe një mundësi e mirë për të promovuar bashkëpunimin rajonal dhe atë dypalësh, si dhe çuarjen përpara të marrëdhënieve në aspektet politike dhe diplomatike, pa lënë mënjanë promovimin dhe shkëmbimet kulturore të vendeve", tha në fund, znj. Kodheli.
Kurse gjenerali amerikan Ben Hodges, nënvizoi se "Shqipëria është shumë e rëndësishme për Aleancën, është pjesë e rëndësishme e stabilitetit në rajon dhe po i tregon kapacitetet e veta Aleancës për operacionet".



Kontingjenti i FSK-së në operacionet e përbashkëta në ushtrimin “Reagimi i Menjëhershëm 16” në Slloveni- Kroaci



Kontingjenti i FSK-së(26 pjesëtarë) mori pjesë në ushtrimin ndërkombëtar "Reagim i Menjëhershëm 2016" së bashku me vendet e NATO-s dhe vendet e rajonit, si: Anglia, Bosnja dhe Hercegovina, Hungaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, SHBA, Sllovenia dhe Shqipëria, mbajtur në Slloveni-Kroaci.

Kontingjenti i FSK-së ishte vendosur në tri lokacione: Novo Mesto, Cerklje dhe Zagreb, ku së bashku me vendet pjesëmarrëse ishte angazhuar në reagimet ndaj sfidave dhe situatave të krijuara.

Komandant i kontingjentit të FSK-s, nënkolonel Fidaim Elshani, tha: "Qëllimi i këtij ushtrimi është i qartë dhe në kohezion me realitetin e krijuar; si kërcënimet e mundshme reale, përballja me kriza të refugjatëve dhe krijimi i forcës adekuate për reagim të menjëhershëm, duke promovuar stabilitet rajonal, forcim të kapaciteteve partnere dhe përmirësim të ndërveprimit të kapaciteteve të NATO-s dhe forcave të armatosura të vendeve anëtare të Partneritetit për Paqe (PFP)". FSK-ja në këtë ushtrim është përfshirë në të gjitha nivelet, si: kontrolli i ushtrimit, oficeri ndërlidhës, Qendra operative e batalionit, Qendra operative taktike, qendrat e bashkëpunimit civilo-ushtarak, e deri tek intervenimet e përbashkëta për eliminimin e mjeteve të pashpërthyera, kërkim-shpëtimin në male, si dhe evakuim dhe trajtim mjekësor.

FSK-ja zhvilloi me sukses ushtrimin fushor “Shqiponja 5”

Ushtrimi fushor "Shqiponja- 5" është realizuar në bazë të Planit vjetor të trajnimeve për vitin 2016, udhëzimeve të komandantit të FSK-së, për grupin punues dhe direktivave të NATO-s, për ushtrime dhe trajnime kolektive. Skenar i ushtrimit fushor ka qenë kriza me refugjatë, dhe është zhvilluar në territorin e tri komunave, Hanit të Elezit, Malishevës dhe Prizrenit. Në ushtrim kanë marrë pjesë gjithsej 652 pjesëtarë me 111 automjete, dhe janë realizuar mbi 30 operacione humanitare të sigurisë.



Në Qendrën Operative të kampit fushor, drejtori i ushtrimit, kolonel Naim Haziri dhe komandanti i kampit nënkolonel Mehmet Lladrovci i njoftuan vizitorët e lartë dhe të pranishmit për procesin dhe fazat e planifikimit, organizimit dhe zhvillimit të ushtrimit fushor.

Udhëheqësit e FSK-së, Gardës Kombëtare të Ajovës, KFOR-it etj., përcollën nga afër demonstrimet e njësive të specializuara të FSK-së, në vend incidente, intervenimin e njësisë së kërkim-shpëtimit të refugjatëve në lumin Drini i Bardhë, menaxhimin e hyrjes së refugjatëve në pikën kufitare, intervenimin e njësisë së Brigadës së Reagimit të Shpejtë, në zonën kufitare për të eliminuar elementet e grupit kriminal "Pandora", si dhe vizitën në Kampin e refugjatëve. Ministri i FSK-së, Haki Demolli, ka përgëzuar FSK-në, oficerët e Gardës Kombëtare të Ajovës, Ushtrinë Amerikane për Evropë, KFOR-in, Policinë e Kosovës dhe agjencitë tjera të Kosovës për zhvillimin me sukses të ushtrimit



fushor Shqiponja 5. Ai, me këtë rast, tha se: "Ushtrimi kishte për qëllim që të testohen respektivisht të demonstrohen, dëshmohen dhe verifikohen në radhë të parë kapacitetet njerëzore dhe ushtarake të FSK-së, si dhe kapacitete teknike, për sfidat e ndryshme qoftë ato të karakterit humanitar, qoftë të karakterit të sigurisë. Ky demonstrim i kapaciteteve të FSK-së është zhvilluar në praninë dhe vëzhgimin e vëzhguesve ushtarakë të vendeve mike që kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit, si nga Shqipëria, Maqedonia, Kroacia dhe Sllovenia. Nga ajo që pamë, mund të themi lirisht se FSK-ja është e gatshme për t'i kryer funksionet dhe aktivitet e parapara sipas mandateve kushtetuese dhe ligjore të FSK-së, që do të thotë se FSK-ja është e gatshme ta ndërrojë mandatin dhe misionin e vet dhe të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës. Kurse komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha: "Operacionet dhe aktivitetet e ushtrimit Shqiponja 5" janë dëshmi që FSK-ja ka kapacitete për kryerjen e përcaktuara me mision. Ushtrimi ka dëshmuar se jemi të aftë për ndërveprime me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Testimi i suksesshëm i njësive dhe suksesi i arritur dëshmon që FSK-ja është e gatshme për detyra dhe përgjegjësi të reja". Objektiv i ushtrimit fushor "Shqiponja 5" ishte trajnimi i liderëve dhe njësive për detyrat kolektive, me qëllim të realizimit të operacioneve komplekse në mbështetje të autoriteteve civile në fazën e planifikimit, ekzekutimit si dhe atë të analizimit, mbajtja e nivelit të gatishmërisë operative, zhvillimi i aftësive ekzistuese, përmirësimi i koordinimit me institucionet e tjera të sigurisë në operacion, dislokimi i forcave nga vendbazimi i përhershëm në zonën e operacionit dhe zbatimi i sistemit të mësimeve të mësuara.

Ushtrimin e kanë përcjellë ministri Demolli, gjeneral Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral Fungo, drejtori i NLAT-it, gjeneral Mosmman, deputetët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, kryetarët e komunave, komandantët e kontingjenteve të KFOR-it, ambasadorë dhe atashe të akreditуar në Kosovë si dhe mysafirë të tjerë të ftuar.

Ministri Demolli vizitoi ushtrimin fushor "Shqiponja 5"



Në orët e vona të pasditës të së martës (25. 10. 2016), ministri i FSK-së, z. Haki Demolli së bashku me stafin e lartë të Ministrisë dhe FSK-së kanë vizituan kampin e FSK-së në fshatin Nashec të Prizrenit. Për skenarin dhe rrjedhat e ushtrimit fushor e njoftoi komandanti i kampit, nënkolonel Mehmet Lladrovci, kurse ecurinë e zhvillimit, ministrin e informoi komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci. Ministri Demolli i ka përgëzuar ushtarët dhe oficerët e FSK-së, dhe posaçërisht ka falënderuar ushtarët e SHBA-ve për Evropë dhe ata të Gardës Kombëtare të Ajovës, për kontributin e tyre në përgatitjen dhe bashkëpjesëmarrjen praktike në këtë ushtrim, duke ngritur nivelin e rezultateve të stërvitjeve dhe ushtrimit fushor "Shqiponja -5".

Ministri Demolli gjatë orëve të vona të natës ka bashkëbiseduar me ushtarë dhe oficerë, ku u interesuar për rrjedhat e ushtrimit, vështirësitë dhe kushtet e përgjithshme të qëndrimit në natyrë. Ai, po ashtu, darkoi në kuzhinën fushore të kampit së bashku me ushtarë dhe eprorë të FSK-së dhe SHBA-ve.



Kadetët e FSK-së student në "WestPoint"

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), u mbajt ceremonia e dorëzimit të certifikatave për dy kadetët e FSK-së, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku, të cilët janë pranuar për studime në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (AUSHBA) „WestPoint". Më këtë rast, ministri Demolli tha se lajmi për pranimin e dy kadetëve të FSK-së në Akademinë Ushtarake „WestPoint", është një prej ngjarjeve më të mira dhe shumë të rëndësishme për FSK-në dhe MFSK-në, sepse bëhet fjalë për shkollimin dhe ngritjen profesionale të dy kuadrove tona në një akademi ushtarake me traditë të gjatë". Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama u shpreh tejet i lumtur, që kadetët e FSK-së këtë vit kanë filluar studimet në Akademinë Ushtarake „WestPoint", akademi kjo me renome botërore. Gjeneral Rama, tha se, ndjehet shumë krenar që promovon këtë sukses, e veçanërisht se ndjehet mirë këtu në mesin e dy kadetëve, që pranojnë certifikatat e pranimit në Akademinë Ushtarake më prestigjioze në botë. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama përgëzoi Arelenën dhe Yllin për suksesin e arritur deri më tani. "Këta dy të rinj kanë arritur që të jenë në mesin e 10 kandidatëve më të mirë prej qindra konkurrentëve nga 150 shtete të ndryshme të Botës, që konkurruan për studime në „WestPoint". Kadetët Shala dhe Dalladaku janë kadetët e parë të Forcës së Sigurisë së Kosovës që kanë konkurruar dhe janë pranuar në Akademinë Ushtarake Amerikane „WestPoint. Ata do të studiojnë në këtë akademi për katër vite dhe pas diplomimit do të kthehen për të shërbyer në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK).

Diplomojnë kadetët e rinj të FSK-së, gjenerata 2016

Në kazermën e FSK-së u zhvillua ceremonia solemne e diplomimit të kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, gjenerata 2016. Ministri Demolli diplomimin dhe gradimin e 9 kadetëve të FSK-së të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së, në gradën e nëntogerit, e cilësoi si një ditë të veçantë për FSK-në. Kjo është dita e kurorëzimit të një pune të gjatë, është dita e ëndërruar që juve ju ka shty para 4 viteve të vendosni që të vishni uniformën dhe të bëheni pjesëtarë të FSK-së, të bëheni oficerë të karrierës. Realizimi i kësaj ëndrre rinore, sigurisht se ka kërkuar punë këmbëngulëse dhe studime të kombinuara në qendrën ushtarake dhe në universitetet civile. Kjo ditë shënon kalimin në një fazë të re zhvillimi, kur juve ju hapet mundësia për t'u aktivizuar në FSK si oficerë aktivë, për të filluar karrierën e oficerit". Për suksesin e kadetëve, ministri Demolli përgëzoi stafin akademik trajnues të KDS-së dhe të QSU-së, për punën e tyre të palodhshme në përgatitjen dhe stërvitjen e kësaj gjenerate. Ministri Demolli më pastaj i porositi kadetët e sapo diplomuar: "Oficerë të rinj, ju sot me të drejtë jeni të mbushur me krenari dhe gëzim, duke na siguruar për një të ardhme me perspektivë të sigurt. Si ministër i MFSK-së ju porosis që të mos harroni se: nuk ka mision më të shenjtë se të jesh oficer në shërbim të mbrojtjes së lirisë dhe demokracisë; vlera dhe parime këto për të cilat gjenerata të tëra kanë sakrifikuar shumë duke dhënë jetën e tyre në altarin e lirisë". Ndërkaq, për shkollimin e kadetëve në QSU ministri u shpreh: "Doktrina e stërvitjes dhe shkollimi i kadetëve të FSK-së, është bazuar



plotësisht mbi dijet dhe shkencën ushtarake dhe standardet e ushtrive më të avancuara, e kombinuar me shkollimin paralelë në institucione civile, por edhe një mundësi e së ardhmes për specializime të ngushta në perspektivën e karrierës ushtarake". Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij me rastin e diplomimit të kadetëve tha: ,,Sot jemi këtu që të shprehim mirënjohjen tonë për guximin dhe vetëmohimin që kanë treguar kadetët gjatë këtyre katër viteve. Ju kaluat sfida të mëdha fizike dhe psikike, me të vetmin qëllim që të edukoheni dhe të përgatiteni për t'i shërbyer vendit dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Por më duhet të ju them që ky është vetëm fillimi i rrugëtimit tuaj në këtë profesion fisnik''

.

Betohen kadetët e rinj të FSK-së



Në kazermën ,,Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) në Prishtinë më 30 shtator u zhvillua ceremonia solemne e betimit të kadetëve, të cilët janë pranuar në vitin akademik 2016 në Qendrën për Studime Universitare (QSU).

Në fjalën e hapjes së ceremonisë, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës z. Haki Demolli, duke ju drejtua kadetëve të rinj, tha: ,,Që nga sot, ju do të jeni në studime që dallojnë dukshëm nga studimet e moshatarëve tuaj. Ju sot po e filloni shkollimin tuaj, i cili do t'ju bëjë të dobishëm dhe të vlefshëm jo vetëm për vetën tuaj, por edhe për popullin, institucionet dhe shtetin tonë në përgjithësi". Në fund të fjalës së tij, ministri Demolli, iu drejtua edhe familjarëve të kadetëve: ,,E di që edhe ju jeni krenarë për sukseset e djemve dhe vajzave tuaja. Prandaj shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj për mbështetjen që iu keni ofruar fëmijëve tuaj, respektivisht kadetëve tanë, në realizimin e synimeve dhe dëshirave të tyre, që të bëhen kadetë, pra oficerë të vendit. Uroj që ndonjëri prej tyre në të ardhmen të bëhet edhe oficerë i lartë i Forcave të Armatosura të Kosovës. Nga ana e tij, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi foli mbi rolin, rëndësinë dhe traditën e shkollimit të kadetëve në FSK dhe shtoi se nga QSU-ja deri më tani kanë diplomuar dhe shërbejnë në FSK 85 oficerë, të cilët janë duke bërë një punë të shkëlqyer nëpër njësitë e tyre. Në fund të fjalës së tij, gjeneral Cikaqi përgëzoi edhe stafin e QSU-së për punën dhe përkushtimin e pareshtur në edukimin dhe kalitjen e oficerëve të rinj të FSK-së. Ndër 16 kadetë të pranuar këtë vit njëri është nga Republika e Shqipërisë. Kadetët do të studiojnë edhe në Universitetin Amerikan në Prishtinë, dhe pas katër vitesh, pra në vitin 2020, do të dalin në detyrë me gradën e nëntogerit.



Diplomojnë kadetë minoritar të FSK-së

Në Akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostollski" të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, diplomuan katër kadetë të FSK-së nga Kosova si dhe të tjerë nga Maqedonia, Bosnja Hercegovina dhe Mali i Zi.
Në emër të Ministrisë së FSK-së, znj. Azemina Qullum, shefe e Zyrës për Komunitete, falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë për ndihmën e vazhdueshme në shkollimin e kadetëve të FSK-së. Ajo tha: "Duke ju falënderuar marrëveshjes për bashkëpunim dypalësh në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë të vitit 2012, është afruar mundësia për pjesëtarët e FSK-së, pjesëtarë të komunitetit serb dhe boshnjak që të shkollohen në nivel të lartë në Akademinë tuaj Ushtarake. Veçanërisht është e rëndësishme të theksoj se këta janë oficerët e parë nga radhët e komuniteteve pakicë të Kosovës, të cilët të shkolluar dhe profesionalisht të përgatitur do t'i bashkohen trupës së oficerëve të FSK-së".



FSK trajnoi "Ekipin për parashutistë"

Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, një ekip oficerësh dhe ushtarësh të FSK-së kanë kryer trajnimin Bazik për Parashutizëm Luftarak në Republikën e Kroacisë, gjegjësisht në Akademinë Ushtarake në Zagreb.
Në këtë trajnim dy javor kanë marrë pjesë: toger Ilir Beqiri, tetar Labinot Kelmendi, tetar Faton Rukovci, ushtar Franjo Kodraj, ushtar Besarta Pacolli dhe ushtar Ilir Kajtazi. Trajnimi është realizuar në dy faza; ku në fazën e parë është mbajtur pjesa teorike për parashutën kryesore MC1-1C dhe atë rezervë T 10R, ndërsa në fazën e dytë është mbajtur pjesa praktike, hedhja me parashutë nga helikopteri MI 17.
Pjesa praktike hedhjes me parashutë është realizuar gjatë ditës dhe gjatë natës, me pajisje personale. Ushtari më i dalluar ishte Franjo Kodraj i cili të gjitha tekstet me shkrim arrin t'i realizoi me rezultatin 100%, dhe të gjitha kërcimet i ka kryer brenda zonës së gjelbër. Gjatë kryerjes së pjesës praktike, pjesëtarët e FSK-së i kanë vizituar edhe zëvendëskomandanti i Komandës se Forcave të Operacioneve Speciale të Kroacisë (KFOS) dhe instruktorë të lartë të kësaj njësie të cilët janë shprehur me fjalët më të mira për pjesëtarët e FSK-së. Në përfundim të kryerjes së këtij trajnimi është mbajtur ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së. Në fund të ceremonisë, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Speciale të Kroacisë, majori Mirko Bosnjak dhe gjithë stafi komandues kanë përgëzuar pjesëtarët e FSK-së për sukseset, si dhe janë shprehur mese të gatshëm të vazhdojnë bashkëpunimin dhe trajnimin edhe në kurse të tjera më të avancuar për parashutizëm, si dhe trajnimet tjera të nivelit më të lartë që ofron K FOS-i.





Ekipi i njëjtë i parashutistëve të FSK-së ka marrë pjesë në 'Javën ndërkombëtare të hedhjes me parashutë ushtarake' në Bazën e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në Ramstein të Gjermanisë.
Në këtë garë ndërkombëtare, me ftese të Forcave Ajrore të SHBA-së, mori pjesë edhe ekipi i parë i parashutistëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Qëllimi i kësaj ngjarje ishte demonstrimi i kapaciteteve të parashutizmit, njohja me procedurat, me parashutat, me mjetet fluturuese të vendeve pjesëmarrëse, ashtu si edhe familjarizimi dhe shkëmbimi i përvojave përkatëse. Gjithashtu është synimi i secilit që në këtë ngjarje të mbledhë sa më shumë krahë të vendeve, të cilat certifikojnë dhe dhurojnë krahë të parashutistëve. Bazuar në rregullat e certifikimit dhe dhënies së krahëve të parashutizmit, këtë vit certifikues ishin: SHBA, Gjermania dhe Izraeli. Kushtet për dhënien e certifikatës dhe krahëve të parashutizmit janë si më poshtë: Ushtaraku parashutist duhet të ketë së paku një kërcim nga një mjet fluturues ushtarak i vendit përkatës, të kërcejë me parashutën e vendit përkatës, të kërcejë nën instruksionet e një mjeshtri të hedhjes të vendi përkatës, etj. Pjesëtarët e FSK-së i përmbushën të gjitha këto kushte dhe prandaj u certifikuan nga të tri vendet certifikuese.
Ekipi i FSK-së, në bashkërendim me stafin e Grupit për Reagim në Kriza (Njësi e Forcave Ajrore të SHBA-së), dhe drejtpërdrejt të kolonelit Jerzy Zubr nga Ushtria e SHBA-së, ka arritur që të hedhet me parashutë dhe të certifikohet nga tri vendet certifikuese; pra me këtë rast, duhet të theksohet se ekipi i FSK-së, me meritë ka arritur të fitojë dhe mund të bart me krenari krahët e SHBA-së, Gjermanisë dhe Izraelit.



Në kazermën „Adem Jashari " të FSK-së u përurua Salla e sporteve



Në ambientet e kazermës „Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së në Prishtinë, u mbajt ceremonia e përurimit të Sallës së sporteve për pjesëtarët e FSK-së.
s Forca e Sigurisë së Kosovës për çdo ditë është duke krijuar mundësi dhe hapësira të reja për zhvillimin e pjesëtarëve të saj si në aspektin intelektual ashtu edhe atë fizik. Kjo sallë sportive do t`u krijojë pjesëtarëve të FSK-së shumë mundësi për realizimin e aktiviteteve të ndryshme fizike. Këshilltari i komandantit të FSK-së, koloneli David Jones, gjatë kësaj ceremonie përurimi ndër të tjera u shpreh se ndjehet mjaft i impresionuar me kushtet e krijuara gjatë periudhës së shërbimit të tij në FSK". Ai flet me respekt për ekipin e futbollit të FSK-së, duke kujtuar edhe disa lojëra të këtij ekipi, siç është loja e zhvilluar në me FSK-së dhe Ushtrisë së Malit të Zi.
FSK-ja në planin e saj zhvillimor të infrastrukturës është duke ndërtuar salla të tilla në të gjitha kazermat.



FSK-ja, Garda Kombëtare e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë mbajtën krosin me moton "Së bashku për paqe"



Në sheshin "Skënderbeu" të Prishtinës, në organizim të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të MFSK-së, u mbajt krosi në atletikë, ku morën pjesë mbi 300 pjesëtarë të FSK-së, pjesëtarë të Gardës Kombëtare të Ajovës dhe pjesëtarë të Ushtrisë Amerikane për Evropë.

Vendin e parë në këtë garë në kategorinë e meshkujve e zuri Jesemin Zverko, të dytin Valdet Brahimi dhe në vendin e tretë u rendit Adnan Ademi, që të tre pjesëtarë të FSK-së, kurse në kategorinë e femrave vendin e parë e zuri ushtarja Donjeta Korpuzi, vendi i dytë i takoi pjesëtares së Ushtrisë Amerikane, rreshter Stefany Stock dhe në vendin e tretë u rendit ushtarja Bahare Bytyçi.

Tri vendet e para u nderuan me medaljen e artë, argjendtë dhe të bronztë si dhe me certifikata, të cilat u ndanë nga ministri i FSK-së, Haki Demolli, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione.


Gara filloi në shtegun nga sheshi "Skënderbeu" deri te rreth-rrotullimi afër Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" në Prishtinë dhe anasjelltas, në një gjatësi prej 5 mijë metrave.














FORCA JONË

Viti V • Nr. 53 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti i V • Nr. 53 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun,
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma ,,Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektronike: informimi.mfsk@gmail.com, informimi.mfsk@rks-gov.net
Tel: 038/551-379

www.mksf-ks.org



www.mksf-rks.org

FORCA JONË

* * * Viti V • Nr. 54 • Shkurt 2017 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Intervistë e Ministrit Haki Demolli, për gazetën "Forca Jonë"

2016-shi, vit i sukseseve dhe ngritjes profesionale të FSK-së

Gazeta "Forca Jonë: *Cilat janë të arriturat e FSK-së, gjatë këtij viti, me cilat mund të krenoheni ju si ministër?*

Ministri Haki Demolli: Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, vitin 2016 e përmbyllën me një numër të madh të sukseseve si në rrafshin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Vlen të theksohet se FSK-ja në rrafshin kombëtar ia ka dalë që më sukses t'iu përgjigjet të gjitha kërkesave të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës, lidhur me rastet emergjente dhe fatkeqësitë e ndryshme natyrore.

Me këtë rast, dëshiroj të theksojë vetëm disa nga aktivitetet në të cilat vërtetë është shpërblyer dhe lavdëruar puna, serioziteti, angazhimi dhe profesionalizmi i pjesëtarëve tanë, pra, paraqitja e djemve dhe vashave të FSK-së.



Sukses jashtëzakonisht i madh është regjistrimi i dy kadetëve të FSK-së, në Akademinë Ushtarake "West Point" në SHBA, që është njëra prej akademive më prestigjioze në Botë, të këtij lloji.

Sukses tjetër në rrafshin ndërkombëtar është edhe Medalja e artë e një skuadre të Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, në ushtrimin garues "Commbrion Patrol" në Britani të Madhe, në të cilën kanë marrë pjesë mbi 120 skuadra nga 16 vende të ndryshme të botës.

Të gjitha këto të arritura gjatë këtij viti më bëjnë të jem krenar, por ajo që më bën të ndihem mirë është edhe besimi i qytetarëve të Kosovës për FSK-në dhe MFSK-së, i shprehur përmes sondazheve që janë publikuar gjatë këtyre ditëve nga Qendra Kosovare për Studimet e Sigurisë, Riinvest dhe nga Kipred.

Gazeta "Forca Jonë": *Cili është bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar?*

Ministri Haki Demolli: Sa i përket bashkëpunimit në planin ndërkombëtar kemi pasur një vit mjaft të suksesshëm, duke filluar nga bashkëpunimi bilateral e deri te iniciativat regjionale dhe më gjerë. Ministria e FSK-së deri më tani ka të nënshkruar 11 Memorandume bashkëpunimi me shtete, kryesisht të regjionit, por edhe më gjerë, një numër i të cilave janë anëtare të NATO-s. Mirëpo, po ashtu, ne kemi marrëveshje bashkëpunimi edhe me Gardën Nacionale të Ajovës-SHBA. Kur jemi te bashkëpunimi me Forcat e Armatosura të SHBA-ve, duhet theksuar faktin se si rezultat i Partneritetit Shtetëror ndërmjet MFSK-së dhe Gardës Nacionale të Ajovës, gjatë këtij viti, pjesëtarët e FSK-së me ushtarët e Gardës Nacionale të Ajovës kanë zhvilluar 55 aktivitete ushtarake të përbashkëta, kur kësaj i shtohen edhe aktivitetet e tjera ushtarake me US-EUCOM, IMET, atëherë shihet se gjatë këtij viti pjesëtarët e FSK-së kanë zhvilluar gjithsej 87 aktivitete të karakterit profesional ushtarak me pjesëtarët e Forcave të Armatosura të SHBA-ve.

Gazeta "Forca Jonë: *Sa po i kushtohet rëndësi shkollimit të kuadrove të reja?*

Ministri Haki Demolli: Edhe në sferën e shkollimit të kadetëve dhe oficerëve të FSK-së, si në vend ashtu edhe jashtë vendit; janë arritur suksese të dalluara. Kështu gjatë këtij viti, kemi regjistruar 15 kadetë të rinj në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, si dhe kemi dërguar për shkollim dhjetëra kadetë të tjerë në akademitë ushtarake të vendeve mike me të cilat kemi bashkëpunim edhe në sferën e shkollimit të kuadrove ushtarake, si në Gjermani, Turqi, Kroaci, Britani të Madhe, Maqedoni,



SHBA etj. Këtë vit me sukses diplomuan edhe katër kadetët e parë nga radhët e komuniteteve të Kosovës, në Akademinë Ushtarake në Maqedoni, të cilët tanimë janë strukturuar në njësitet tona dhe janë duke dhënë kontributin e tyre në ndërtimin dhe zhvillimin e FSK-së.

Gazeta "Forca Jonë: *A është e gatshme FSK të shndërrohet në ushtri?*

Ministri Haki Demolli: MFSK dhe FSK, si bartëse të procesit të Rishikimit të Strategjisë së Sektorit të Sigurisë, pas aprovimit të rekomandimeve nga ky proces, gjatë periudhës kohore 2012-2014, ka punuar dhe është duke punuar me intensitet të lartë në implementimin e tyre.

Vlen të theksohet se, që nga fillimi, por edhe gjatë zhvillimit të këtij procesi është realizuar në bashkëpunim me ekipet e autorizuara nga SHBA-të, konkretisht DIRI-n (Defense Institute on Reform Initiative-Iniciativa e Reformave në Institucionet e Mbrojtjes), si dhe me Gardën Kombëtare të Ajovës të SHBA-ve, përmes Zyrës së Bashkëpunimit për Mbrojtjen (ODC) dhe faktorët tjerë relevantë ndërkombëtarë.

Ky proces ka rezultuar me përgatitjen e draft-ligjit dhe dokumenteve të nevojshme të planifikimit strategjik të procesit të zhvillimit dhe transformimit të Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Ministria e FSK-së e ka themeluar Departamentin për Transformim dhe Standardizim i cili ka punuar gjatë tërë kohës dhe është në prag të finalizimit të Pakos së dokumenteve të planifikimit strategjik, që nënkupton Konceptin e Implementimit të rekomandimeve të RSSS-së, si dhe Planin e Veprimit për implementimin e rekomandimeve, pastaj strukturën e Ministrisë së ardhshme të Mbrojtjes si dhe të Forcave të Armatosura të Kosovës bazuar në misionin e ri dhe detyrat esenciale.

Andaj duke pasur parasysh atë që u theksua më lartë, përfundimisht dhe me plotë arsye mund të thuhet se, MFSK i ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme për transformim, pra FSK-ja është e gatshme për transformim në Forcë të Armatosur të Kosovës.

Gazeta "Forca Jonë: *Kur pritet të bëhet shndërrimi i FSK-së në ushtri?*

Ministri Haki Demolli: Më lartë theksova se, për transformimin e FSK në Forcë të Armatosur, kushti kryesor është aprovimi i Amendamenteve Kushtetuese dhe Projektligjit për Transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Është e ditur se këto dy veprime duhet të zhvillohen në Kuvendin e Kosovës, andaj duhet ritheksuar se, fillimi i tërë procesit të transformimit është "në duar" të Kuvendit të Kosovës, vendimi i të cilit do të jetë i mirëpritur jo vetëm nga MFSK-ja dhe të gjithë pjesëtarët e FSK-së, por thellësisht jam i bindur edhe nga të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Andaj shpresoj dhe dëshiroj që viti 2017, të jetë vit i ndryshimeve, gjatë të cilit, do të aprovohen këto akte në Kuvendin e Kosovës dhe kështu do të realizohet një ëndërr e kamotshme e institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama u prit nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, më 17 janar 2017, priti në një takim komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me të cilin biseduan për të arriturat e FSK-së, si dhe ngritjen e kapaciteteve të saj për t'iu përgjigjur nevojave të Republikës së Kosovës për të garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve të saj. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, e informoi presidentin Thaçi me të arriturat e përgjithshme të



FSK-së dhe ngritjen e kapaciteteve të kësaj force. "Forca e Sigurisë së Kosovës është trajnuar sipas standardeve më të larta të NATO-s dhe është e gatshme të jetë ushtri e Kosovës"-, u shpreh gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi u shpreh i kënaqur me të arriturat e Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe me planet për të ardhmen e kësaj force. "Forca e Sigurisë së Kosovës është rekrutuar dhe është përgatitur për bashkëpunim me NATO-n. Është forcë profesionale e standardeve të NATO-s, forcë shumetnike, me përfaqësim të duhur gjinor dhe e gatshme t'u përgjigjet të gjitha sfidave të sigurisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës", u shpreh presidenti Hashim Thaçi.

Komandanti i FSK-së priti shefin e Komandës Amerikane për Operacione Speciale në Evropë

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur në takim, në Ministri, shefin e Komandës Amerikane për Operacione Speciale në Evropë, gjenerallejtënant Mark Shchwartz, me bashkëpunëtorë. Në takimin e përbashkët, Komandanti i FSK-së e njoftoi gjeneralin Shchvarc, me zhvillimin dhe të arriturat e FSK-së, operacionet, trajnimet, shkollimet si dhe përgatitjet që janë bërë dhe po bëhen në transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Gjithashtu, gjenerallejtënant Rrahman Rama i paraqiti gjeneralit amerikan nevojën që Komanda Amerikane për Operacione Speciale në Evropë, ta mbështes FSK-së në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve aktuale të FSK-së e gjithashtu edhe të kapaciteteve të mbrojtjes për Forcën e Armatosur të Kosovës. Nga ana e tij, shefi i Komandës amerikane për operacione speciale në Evropë, gjenerallejtënant Mark





Shchwartz shprehu gatishmërinë që FSK-në, ta mbështesë me trajnime dhe shkollime për kapacitetet aktuale, që FSK-ja ka aktualisht sipas misionit; si fusha e kërkim-shpëtimit, etj., si dhe u shpreh se do të analizohen mundësitë dhe do të identifikohen fushat e mbështetjes edhe për të ardhmen. Më pas, Komandant Rama dhe gjeneralin Shchwartz vizituan Regjimentin e Mbrojtjes Civile(RMC), të FSK-së në kazermën ,,Evropianët e rinj" në Pomozatin, ku u pritën nga komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri. Fillimisht në Pomozatin, kolonel Haziri i njoftoj gjeneralët mbi misionin, detyrat dhe aktivitetet e Njësisë që ai komandon, si dhe më pas vizituan Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, ku u njoftuan ,mbi procedurat e ngritjes së Qendrës si dhe mbi vizionin për zhvillimin e saj në të ardhmen. Në fund të vizitës, gjeneral Rama, gjenerali amerikan Shchwartz si dhe kolonel Haziri panë nga afër disa prej kapaciteteve të njësive të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, takoi ambasadorin e Mbretërisë së Suedisë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Haki Demolli, priti (17 janar 2017) ambasadorin e Mbretërisë së Suedisë, z. Henrik Nilsson. Në takimin e përbashkët të ministrit Demolli dhe ambasadorit Nilsson u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Suedisë, me theks te veçantë për bashkëpunimin e mirë ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Suedisë.

Gjithashtu, në takim u bisedua edhe për ndihmën dhe mbështetjen që ka dhënë dhe po vazhdon të japë Mbretëria e Norvegjisë që nga kontributi i saj për sigurinë dhe paqen në Kosovë, pastaj ndihmën dhe mbështetjen e pakursyer në drejtim të ngritjes, zhvillimit dhe fuqizimit të institucioneve të shtetit. Ministri Demolli dhe ambasadori Nilsson biseduan edhe për bashkëpunimin e mirë ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Suedisë. Njëherësh, ministri Demolli e falënderoi ambasadorin suedez edhe për mbështetjen e pakursyer të Mbretërisë së tij gjatë ngritjes dhe konsolidimit të Qendrës së Trajnimit të FSK-së për Kërkim Shpëtim, ku një kontribut të çmuar kanë dhënë ekspertët e saj të fushës së kërkim-shpëtimit si dhe ekspertët - këshilltarë në kuadër të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe FSK-në. Ministri Demolli dhe ambasadori Nilsson, gjithashtu, ranë dakord që të konkretizohet ideja për zyrtarizmin e marrëdhënieve me një marrëveshje dypalëshe e cila do të përcillej në vazhdimësi me planin e sinkronizuar të aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen ndërmjet dy ministrive dhe dy forcave përkatëse.



Diplomatë të rinj nga Shqipëria vizituan MFSK-në

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli priti drejtorin e Akademisë Diplomatike Shqiptare, z. Edmond Trako, këshilltarin e Ministrisë për Punë të Jashtme të Shqipërisë, z. Martin Gjoka dhe znj. Romina Hyseni, diplomate në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, si dhe një delegacion të diplomatëve të rinj nga MPJ e Shqipërisë. Gjatë këtij takim, ku ishin të pranishëm edhe zëvendësministri i MFSK-së, zotëri Muhamet Latifi, shefi i kabinetit zotëri Latif Leka dhe këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Fadil Hadergjonaj, ministri Demolli i njoftoi diplomatët



shqiptarë lidhur me misionin, detyrat, aktivitetet, zhvillimet dhe bashkëpunimin e suksesshëm ndërkombëtar të MFSK dhe FSK me partnerët strategjikë të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Duke u ndalur në zhvillimet e fundit, ministri Demolli foli në veçanti për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, për synimet e Kosovës për anëtarësim në NATO dhe Bashkim Evropian, e gjithashtu edhe për anëtarësimin e Kosovës në iniciativat rajonale, evropiane dhe globale.

Nga ana e tyre, diplomatët shqiptarë, duke paraqitur edhe një varg pyetjesh me interes nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes, falënderuan ministrin e FSK-së Haki Demollin për pritjen dhe për informacionet e shumta që ai solli për ta rreth zhvillimeve në FSK dhe zhvillimeve të përgjithshme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së priti drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, dr. Shkëlzen Sylaj dhe drejtori i Departamentit Mjekësor të Ministrisë, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj pritën në takim në MFSK drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), prof. dr. Naser Ramadanin të shoqëruar nga bashkëpunëtorët: prof. dr. Naim Jerliu, prof dr. Sefedin Muqaj dhe zotëri Azem Geci, drejtor i Administratës. Në takimin e përbashkët të sekretarit Sylaj dhe drejtorit të IKSHPK Ramadani u bisedua për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe konkretizimin e aktiviteteve në të ardhmen, sipas marrëveshjes zyrtare të bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe IKSHPK-së. Delegacioni i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës në krye me prof. dr. Naser Ramadanin i shoqëruar edhe nga drejtori i Departamentit të Mjekësisë në MFSK, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj vazhduan vizitën në Kompaninë e Mjekësisë të Komandës së Forcave



Tokësore(KFT) të FSK-së, ku u njoftuan me kushtet e punës, kapacitetet e kompanisë si dhe me stafin mjekësor. Gjithashtu, delegacionin e IKSHPK-së e priti edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i cili bashkë me pjesëtarët e delegacionit shkëmbyen ide për mundësitë e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, sidomos në disa aktivitete të FSK-së për realizimin e të cilave vlerësohet si e nevojshme mbështetja e IKSHPK-së

Komandanti i KDS-së, gjeneral Enver Cikaqi priti Atasheun Amerikan të Mbrojtjes dhe zv. drejtorin e NALT-it



Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Enver Cikaqi priti në vizitë atasheun amerikan të Mbrojtjes kolonelin Jeffrey Fischer, e cila vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit që KDS me Ambasadën Amerikane. Gjatë takimit komandanti i KDS-së e njoftoi atasheun amerikan me të arriturat e KDS-së, planin e trajnimit për vitin 2017 dhe trajnimet të cilat janë duke u realizuar në KDS. Po ashtu gjeneral Cikaqi falënderoi atasheun amerikan për ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë ushtria amerikane, e në veçanti pjesëtarët e kampit Bondsteel, të cilët e kanë mbështetur ndër vite KDS-në përmes trajnimeve të shumta.

Atasheu amerikan, kolonel Jeffrey Fischer, tha se ndjehet tejet i lumtur kur i sheh pjesëtarët e FSK-së që kanë avancuar kaq shumë në aspektin profesional, si dhe vlerësoi lartë angazhimin e tyre për të marrë njohuri të reja. Atasheu amerikan premtoi vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, ndërsa gjeneral Cikaqi e vlerësoi lartë vizitën e atasheut amerikan në KDS.

Po ashtu në vizitë zyrtare në KDS zhvilloi edhe zëvendësdrejtori i Ekipit Këshillëdhënës Ndërlidhës i NATO-s (NALT) Mark Theovald, i cili u prit nga komandanti i KDS-së. Gjatë vizitës së tij të parë në KDS, drejtori i NALT-it u njoftua nga komandanti i KDS-së me aktivitetet të cilat zhvillohen në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, me nevojat e kësaj komande dhe me angazhimin e pjesëtarëve të saj. Me këtë rast gjeneral Cikaqi vlerësoi lart rolin dhe rëndësinë e NALT-it dhe bashkëpunimin e deritashëm, duke qenë mirënjohës për kontributin e tyre sidomos në fushën e trajnimeve dhe doktrinës ku ekipi i NATO-s ka ndihmuar KDS-në.

Ndërkaq, zv. drejtori i NALT Mark Theovald premtoi angazhim edhe më të madh në të ardhmen, duke theksuar thellimin e këtij bashkëpunimit edhe në fusha tjera në nivel të përgjithshëm të FSK-së.

Ministri Haki Demolli nderoi me mirënjohje nënkolonelin amerikan Jeff Erickson

Ministri i MFSK-së, Haki Demolli priti në takim lamtumirës, këshilltarin e lartë të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe Forcën (NALT), nënkolonelin Jeff Erickson. Ministri Demolli shprehu konsideratë të lartë për angazhimin dhe kontributin e ushtarakut amerikan të Gardës Kombëtare të Ajovës, i cili për njëmbëdhjetë muaj shërbeu-këshilltar i lartë në NALT dhe Logjistikë. Ministri Demolli, në shenjë respekti dhe vlerësimi e nderoi me Mirënjohje nënkolonelin Erickson, duke treguar njëherësh edhe kujdesin dhe falënderimin për mbështetjen që ka dhënë dhe po vazhdon të jap Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për MFSK-në dhe FSK-në. Nga ana e tij, nënkolonel Jeff Erickson u shpreh se shërbimi në Kosovë, ka qenë për mua një përvojë e jashtëzakonshme dhe se viti i qëndrimit këtu dhe shërbimi në mbështetje të MFSK-së dhe FSK-së do të jenë të paharruara.



FSK-ja ndihmon qytetarët e komunitetit joshumicë në Graçanicë



FSK-ja i dhuroi një donacion humanitar (batanije, jastëkë dhe mbulesa) Kishës Ortodokse Serbe në Graçanicë, ndihmë për qytetarët e komunitetit jo shumicë të këtij vendbanimi. Dorëzim pranimi i donacionit humanitar të FSK-së, u bë në ambientet e Manastirit Graçanica. Në emër të FSK-së, donacionin humanitar e dorëzoi nënkolonel Afrim Veseli, shef i Sektorit për Bashkëpunim me Agjencitë në kuadër të Departamentit për Marrëdhënie Civilo-Ushtarake në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ndërsa e pranoi prifti Sergjan Stankoviq, zyrtar i Manastirit. Prifti Stankoviq, me këtë rast, falënderoi Forcën e Sigurisë së Kosovës, ambasadën e SHBA-ve, si dhe KFOR-in amerikan, për ndihmën e ofruar për qytetarët e Graçanicës. "Kjo ndihmë është e mirëpritur në këto kushte të vështira atmosferike dhe ekonomike. Prandaj falënderoj ambasadën e SHBA-ve, KFOR-in amerikan dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës", shtoi pos tjerash prifti Stankoviq. Ndërsa, nënkoloneli Afrim Veseli, tha se FSK-ja deri më tani ka kryer shumë projekte humanitare në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallime feje dhe kombi. Ai premtoi se, FSK-ja edhe në të ardhmen, do të jetë së bashku me të gjithë qytetarët e Kosovës, në ndihmën e tyre si dhe në realizimin e projekteve, qofshin ato humanitare dhe projekteve tjera e që janë në shërbim të qytetarëve. Gjithashtu, nënkoloneli AfrimVeseli falënderoi edhe ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, si dhe KFOR-in amerikan, për përkrahjen e vazhdueshme për FSK-në, qofshin në dhënien e ndihmave humanitare dhe në realizimin e projekteve humanitare.

Pjesëmarrja e suksesshme e FSK-së në trajnime rajonale dhe ndërkombëtare

Skuadra e FSK-së dekorohet me medaljen e artë në trajnimin 'Cambrian Patrol' në Mbretëri të Bashkuar

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) gjatë vitit 2016, ka marrë pjesë në shumë ushtrime dhe trajnime me karakter rajonal dhe ndërkombëtar, si në: Maqedoni, Kroaci-Sllloveni, Britani, Turqi, Shqipëri, Gjermani, SHBA etj. Njësitet/skuadrat e FSK-së në trajnimet rajonale dhe ndërkombëtare kanë treguar rezultate të shkëlqyeshme, duke u nderuar edhe me medalje, mirënjohje dhe lëvdata për profesionalizmin, përkushtimin, disiplinën dhe suksesin e arritur në këto trajnime. Skuadra e Brigadës së Reagimit të Shpejtë e FSK-së, në mesin e qindra skuadrave, është dekoruar me medalje të artë në ushtrimin më sfidues dhe më prestigjioz në botë "Cambrian Patrol" të mbajtur në Wells të Mbretërisë së Bashkuar. Gjithashtu me shpatën e argjendtë po në Mbretërinë e Bashkuar është nderuar nga Princi Carls togeri Ismajl Hoxha, ndërsa toger Manushaqe Nura shpallet më e mira në ushtrimin ndërkombëtar të mbajtur në Kroaci dhe Sllloveni. Rezultate të mira treguan edhe kadetët e FSK-së në Maqedoni dhe pjesëtarët tjerë të FSK-së, pjesëmarrës në shtete të tjera. Toger Manushaqe Nura, udhëheqëse e skuadrës së FSK-së në ushtrimi "Cambrian Patrol"në Wells të Mbretërisë së Bashkuar, thotë se, gjatë zhvillimit të patrullës, skuadra e FSK-së edhe pse për herë të parë ka marrë pjesë tregoi një profesionalizëm të jashtëzakonshëm duke arritur të njëjtin nivel me njësitë me elite të ushtrive më të zhvilluara në botë. Në ushtrimin "Cambrian Patrol" përveç 109 skuadrave nga njësi të ndryshme të ushtrisë britanike, kanë marrë pjesë edhe 18 skuadra të ushtrive nga vendet si Gjermania, Italia, Zvicra, Kanadaja, Pakistani, Nepali, Brazili, Kili, Bosnja dhe Hercegovina, Irlanda, India, Belgjika, Çekia, Australia, Zelanda e Re, Gjeorgjia, Meksika dhe Lituania. "Ftesën për të marrë pjesë në këtë ushtrim, qysh në nëntor të vitit të kaluar e kemi marrë nga Ministria e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar. Më pas, skuadra e BRSH-së ka filluar përgatitjet intensive që kanë zgjatur rreth nëntë muaj të plotë, përfshirë tre muaj parapërgatitje, pesë muaj trajnim intensiv dhe një muaj trajnim familjarizues me regjimentin "Royal Irish" të Ushtrisë



Britanike. Me kthimin e nëntoger Ismail Hoxhës nga shkolla e këmbësorisë së ushtrisë britanike ka nisur trajnimi intensiv, ku kanë filluar përgatitjet për aftësimin e trupave në të gjitha fushat specifike të kërkuara në këtë ushtrim. Përveç përgatitjes së jashtëzakonshme fizike skuadra jonë ka arritur edhe një nivel mjaft të lartë të gatishmërisë në përmbushjen e të gjitha misioneve të njësiteve të vogla që operojnë në misione me rëndësi të veçantë. Një kujdes i posaçëm i është kushtuar edhe testimeve të vazhdueshme, duke pasur për qëllim që drejt këtij suksesi ekiporë të shkojmë me hapa të sigurt dhe të mos lëmë vend për befasi, gjë që edhe ka ndodhur gjatë ushtrimit final në Britani. Skuadra jonë, qysh nga fillimi e deri në fund, ka qenë shumë e saktë në përmbushjen e të gjitha kritereve për misionet e caktuara të dhëna gjatë ushtrimit. Element kryesor për arritjen e objektivave të këtij trajnimi ka qenë vet ekipi i BRSH-së mbështetur maksimalisht nga Batalioni i Tretë i BRSH-së, Komanda e BRSH-së me komandantin e saj kolonel Xhevahir Gecin dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama. Në fazën e fundit të këtij trajnimi, e cila ishte edhe faza familjarizuese, kemi qëndruar rreth tri javë në Batalionin e Parë të trupave irlandeze të këmbësorisë, ku jemi njohur me armët dhe pajisjet e mundshme që do të shfrytëzohen gjatë ushtrimit. "Suksesi në ushtrimin "Cambrian Patrol"në Mbretërinë e Bashkuar ka qenë një tjetër dëshmi që FSK-ja po shkon me hapa të sigurt drejt zhvillimit të një force profesionale, duke nxjerrë kuadro të rinj që në ngjarje të ndryshme janë treguar konkurrentë serioze për ushtritë e vendeve të zhvilluara, vazhdon toger Nura. "Ky ushtrim është mbajtur në tetë faza, kurse skuadra e FSK-së e ka zhvilluar patrullën e saj 48 orësh në fazën e gjashtë nga data 19 deri më 21 tetor 2016. Arsyeja e mbajtjes së ushtrimit në tetë faza është për shkak të pjesëmarrjes së shumë



ekipeve, si nga ushtria britanike ashtu edhe nga vendet mysafire, si dhe nga ekipet e kombinuara të NATO-s. Në të gjitha fazat përfshihen nga 7 deri 9 ekipe", thotë toger Nura. "Gjatë zhvillimit të patrullës, skuadra e FSK-së, edhe pse për herë të parë po merrte pjesë në një ushtrim të këtij niveli, ka treguar një profesionalizëm të jashtëzakonshëm duke arritur të njëjtin nivel me njësitë elitare të ushtrive më të zhvilluara në botë. Kontingjenti ynë ka treguar se është konkurrent i fortë pa marrë parasysh se ekipet tjera kanë pasur edhe eksperienca të mëhershme në këtë garë. Në një farë forme, mund të themi se kemi dëshmuar se vullneti dhe përkushtimi i madh shpeshherë e mposhtin eksperiencën". Pjesëtarët e skuadrës së FSK-së të cilët fituan medaljen e artë janë: Toger Manushaqe Nura-menaxher i skuadrës, nëntogerët Ismail Hoxha-komandant skuadre dhe Fiton Kastrati-zëvendëskomandant skuadre, tetarët: Feti Pronaj, Mensur Haziri dhe Daut Nishori, si dhe ushtarët: Kushtrim Abazi, Valon Hajdari, Qemajl Abazi, Fatmir Maçastena, Liridon Thaçi, Nexhip Begu dhe Agim Qorri. Toger Nura, duke u shprehur mjaft e emocionuar, tregon se deri në fazën e 6-të vetëm 10 skuadra, përfshirë edhe skuadrën e FSK-së, kanë arritur të dekorohen me medaljen e artë, shumë skuadra të tjera kanë arritur vetëm ta përfundojnë ushtrimin ose të marrin medaljen e argjendtë dhe të bronzit, ndërsa 16 të tjera për arsye shëndetësore apo në mungesë të përgatitjeve të mjaftueshme janë tërhequr nga ushtrimi. "Vlen të ceket se skuadra jonë ka përfunduar me sukses të plotë, pa lëndime dhe ka qenë jashtëzakonisht entuziaste edhe në fazën përfundimtare. Këtë e ka dëshmuar edhe gjenerallejtënant Rrahman Rama, i cili gjatë vizitës së tij në terren ka vërejtur që skuadra e FSK-së ka qenë gjithmonë në nivel të lartë gatishmërie. Po ashtu skuadra e FSK-së është përgëzuar për disiplinën dhe gatishmërinë e saj të treguar gjatë këtij ushtrimi edhe nga gjeneral brigade Richard Allen". Ushtrimi "Cambrian Patrol" daton që nga viti 1959, ku për herë të parë u planifikua nga ushtarët e këmbësorisë si ushtrim i shkurtër vikendi, për t'u bërë më vonë një nga ushtrimet kryesore në Ushtrinë Britanike dhe në mbarë botën si një ndër patrullat më të vështira. Këtë e dëshmon edhe fakti se vetëm një numër i vogël skuadrash arrijnë të dekorohen me medalje të artë dhe shkalla e dështimit është mjaft e lartë. Vlen të përmendet edhe një fakt historik, ku gjatë mbajtës së kësaj gare shumë vite më parë, ka ndodhur një incident fatal në një shkollë të asaj zone, ku të gjitha ekipet e "Cambrian Patrol" janë urdhëruar të shkojnë direkt nga ushtrimi në një intervenim real, ku fatmirësisht kanë arritur të shpëtojnë shumë fëmijë të përfshirë në incident. "Meqenëse kjo është hera e parë që Kosova merr pjesë në këtë lloj ushtrimi, dekorimi me medaljen e artë i ka lënë të befasuar si vendin nikoqir ashtu edhe vendet tjera pjesëmarrëse. Kjo paraqitje e suksesshme e skuadrës ka bërë që FSK-ja të njihet nga vendet pjesëmarrëse si një forcë serioze dhe shumë profesionale, ku pa dyshim që në të ardhmen si rezultat pritet të rrisë bashkëpunimin me ushtritë e vendeve të tjera". Ceremoninë e dekorimit me medaljen e artë, nga afër, e ka ndjekur edhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, i cili duke parë nivelin e sfidave gjatë këtij ushtrimi është ndarë jashtëzakonisht i kënaqur me paraqitjen e skuadrës së FSK-së, të cilën e ka përgëzuar për të arriturat në arenën ndërkombëtare. Si përfundim, falë këtij përkushtimi erdhi edhe medalja e artë, e cila i solli jo vetëm FSK-së por edhe Kosovës dhe gjithë qytetarëve të saj emocione të veçanta. Ketë e dëshmon edhe pritja e jashtëzakonshme nga të gjitha instancat shtetërore me rastin e kthimit të skuadrës tonë në Kosovë. Ky sukses dhe shumë suksese të njësive tjera, janë dëshmi që FSK-ja po ecën me hapa të sigurt drejt zhvillimit të saj, si një forcë profesionale dhe e gatshme për t'u përballur në konkurrencë serioze me ushtritë e vendeve të zhvilluara të botës.







Në KDS u mbajt manifestimi për fillimin e ciklit të kurseve trajnuese për pjesëtarët e FSK-së

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), të FSK-së në Ferizaj, më 17 janar, u mbajt ceremonia e fillimit të mbajtjes së kurseve për pjesëtarët e FSK-së për vitin 2017. Ceremonia filloi me intonimin e himnit shtetëror të Republikës së Kosovës, dhe është e një rëndësie të veçantë sepse për kursantët shënon ditën kur ata fillojnë udhëtimin e tyre drejt ngritjes së karrierës profesionale dhe përfitimit të njohurive dhe përvojave të reja, ndërsa për stafin e KDS-së dhe instruktorët e saj, shënon ditën kur ata fillojnë ekzekutimin e një plani i cili ka kaluar nëpërmes një procesi të gjatë të planifikimit dhe përgatitjeve të kurseve për liderë luftarakë, për informatikë, për procedurat e udhëheqjes së trupave, etj. Me këtë rast, ministri i FSK-së, Haki Demolli, premtoi mbështetjen e FSK-së në këtë drejtim edhe në të ardhmen, duke shtuar, se: "Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes po vazhdon të jetë një ndër aktorët kryesorë dhe jetikë për arsimimin dhe stërvitjen e pjesëtarëve tanë, qoftë në aspektin individual, qoftë në atë kolektiv, e cila është rritur dhe zhvilluar ndër vite dhe është konsoliduar mjaft mirë në përputhje me kërkesat dhe nevojat arsimore dhe stërvitore të njësive të FSK-së". Ministri Demolli, më tej shtoi: "Ne si ministri kemi nxjerrë objektivat dhe kemi hartuar politikat e stërvitjes, dhe synimi ynë është që përmes arsimimit dhe stërvitjes të formojmë ushtarë dhe personel të motivuar, të disiplinuar dhe të aftë, që veprojnë si individë, në përbërje të grupit të njësisë. Këto cilësi formohen, zhvillohen dhe përhapen nëpërmjet programeve institucionale të organizuara në përudha dhe afate kohorë, faza dhe module në institucionet e stërvitjes. Ne si ministri si dhe Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të mbështesë në të gjitha fushat nevojat dhe kërkesat tuaja për stërvitje, bazuar në programet bashkëkohore. Ministri Demolli, në fund falënderoi stafin udhëheqës, pjesëtarët e KFOR-it, këshilltarët, kursantët dhe pjesëmarrësit e tjerë. Ndërsa, drejtori i Drejtorisë së Operacioneve në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi përshëndeti të pranishmit në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rraham Ramës, duke shtuar: "Sot është një ditë e veçantë për ne, sepse po shënojmë fillimin e aktiviteteve si, shkollimin e pjesëtarëve të FSK-





së për vitin 2017, si vazhdimësi të ngritjes tonë profesionale dhe me standarde të nivelit ndërkombëtar". Kurse, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes-gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjatë fjalës së tij, me këtë rast, tha se, për ta realizuar misionin tonë po zhvillojmë kurse të ndryshme profesionale me anë të të cilave synojmë zhvillimin, edukimin dhe trajnimin e ushtarakëve dhe udhëheqësve për aftësimin e pjesëtarëve tanë, duke ndikuar kështu në ngritjen e një force profesionale. Gjatë këtij viti në KDS do të realizohen 30 kurse me gjithsej 51 gjenerata të kursantëve, duke përfshirë të gjitha njësitet e FSK-së. Sot po fillojmë me disa prej tyre, si: kursi për informatikë, për procedurat e udhëheqjes së trupave, për lider luftarak, kursi i gjuhës angleze, etj. Të gjitha këto kurse do të zhvillohen në Qendrën për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve, Qendrën e Stërvitjes Specialistike, Qendrën e Stërvitjes Kolektive, Qendrën e Stërvitjes Bazike dhe Qendrën për Studime Universitare. Gjeneral Cikaqi, theksoi se këto kurse janë shumë të rëndësishme për ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Ai potencoi edhe bashkëpunimin e mirë, që KDS-ja ka me të gjitha institucionet e Qeverisë së Kosovës, si ato lokale, qendrore, regjionale, organizatat joqeveritare, NALT-in, KFOR-in amerikan dhe partnerë tjerë të rajonit. Komandanti i KDS-së, gjeneral Cikaqi, falënderoi MFSK/FSK-në, KFOR-in amerikan, këshilltarët e NALT-it, për mbështetjen në realizimin e detyrave të përgjithshme, si dhe nga instruktorët e FSK-së kërkoi angazhim edhe gjatë këtij viti, "se vetëm me punë profesionale dhe këmbëngulëse mund të arrini rezultate të shkëlqyeshme dhe të bëheni shembull i mirë për të tjerët".

FSK-ja dhuroi mbi 560 doza gjak për qytetarët e Kosovës

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës, gjatë aksionit humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut janë dhuruar 568 doza gjak për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, bazuar në planin e veprimit për vitin 2017, dhe, në bashkëpunim me Departamentin Mjekësor në MFSK dhe Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, kanë organizuar aksionin për dhurimin vullnetar të gjakut nga pjesëtarët e MFSK-së dhe FSK-së. Ky aktivitet është paraparë të realizohet dy herë në vit, bazuar edhe në planin e punës së DBCU-së për vitin 2017, si një aktivitet me rëndësi të veçantë. Aksioni për dhurimin e gjakut u realizua në të gjitha njësitë dhe kazermat e FSK-së, sipas një plani të dizajnuar paraprakisht. Pjesëtarët e FSK-së, si zakonisht edhe kësaj here, treguan gatishmëri për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Drejtori i DBCU-së, z. Hajrush Kurtaj, lidhur me këtë aksion u shpreh: "Ne të gjithë po ndjehemi krenarë që me gjakun tonë të dhuruar vullnetarisht po arrijmë të shpëtojmë jetë njerëzish pa dallime". Ndërkaq, menaxherit për marketing në QKTGJK-së, zoti Fadil Mahmuti, vlerësoi lart interesimin e madh të pjesëtarëve të FSK-së dhe stafit civil të MFSK-së, në përgjigje të këtij aksioni. Drejtori i Departamentit të Mjekësisë në



MFSK, dr. Xhevdet Tahiraj, duke u shprehur për këtë aksion, nder tjera, tha: "Që ditën e parë, këtij aksioni i janë përgjigjur një numër i madh i pjesëtarë të MFSK-së dhe FSK-së, të cilët tashmë e kanë bërë traditë organizimin e aksionit humanitar për dhurimin e gjakut, me moton; një pikë gjak për shpëtimin e një jete". Aksioni humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut, është realizuar nga data 16 janar deri më 27 janar 2017.

Oficerja amerikane Jodi Marti i bashkohet aksionit të dhurimit të gjakut në FSK

Aksioni humanitar i dhurimit vullnetar të gjakut në kuadër të FSK-së ka filluar më 17 janar 2016. Këtij aksioni i është bashkuar edhe shefja e Zyrës së Bashkëpunimit Ushtarak (ODC) të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, major Jodi Marti së bashku me oficerë të lartë dhe zyrtarë tjerë të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Major Jodi Marti dhe nënkolonel Ali Krasniqi, pas dhurimit të gjakut, u shprehën se ndjehen mjaft të kënaqur që u bënë pjesë e aksionit që me



gjakun e tyre mund të shpëtojnë jetë njerëzish. Duhet cekur se aksionit të dhurimit vullnetar të gjakut edhe herëve tjera u janë bashkuar edhe zyrtarë tjerë që veprojnë në kuadër të NALT-it, (Zyrës Këshillues Ndërlidhe të FSK-së).

Studentë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, vizitë tematike në MFSK

Studentët e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, programi master-dega e Arkivistikës, me profesorin dr. Haxhi Ferati, vizituan Ministrinë për FSK-në, në kuadër të zhvillimit të lëndës; Historiku i Institucioneve të Kosovës. Vizita u realizua në kuadër të bashkëpunimit të Departamentit të BCU-së, dhe Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë kësaj vizite studentët u njoftuan, nga major Hysen Berisha, UD-i Sektorit të Transformimit dhe Modernizimit në kuadër të këtij Departamenti, me zhvillimet e FSK-së, misionin, strukturën, kapacitet, operacionet, trajnimet; planifikimin, rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë dhe shndërrimin e Forcës së Sigurisë në Forca të Armatosura të Kosovës. Gjithashtu, major Berisha i njoftoi studentët edhe me sukseset e arritura të FSK-së; ngritjen profesionale, trajnimin, shkollimin, si dhe bashkëpunimin dhe partneritetin e ndërtuar me vendet anëtare të NATO-s dhe vendet e tjera, si ato rajonale dhe ndërkombëtare. Po ashtu ai foli edhe fushëveprimin e këtij institucioni të rëndësishëm si: pastrimin e fushave të minuara,



operacionet e kërkimit-shpëtimit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, si dhe me shumë aktivitete tjera. Major Berisha i njoftoi studentët me të arriturat e njësive të FSK-së në gara të ndryshme ushtarake jashtë vendit, si në Maqedoni, Kroaci, Britani të Madhe dhe shtete të tjera, ku njësitet e FSK-së, kanë marrë pjesë. Në fund, major Berisha i njoftoi studentët edhe me Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe përgatitjeve për shndërrimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Ndërsa për veçoritë e MFSK-së dhe FSK-së, si institucion me besueshmi më të lartë nga qytetarët; transparencë, Planin e integritetit, procedurat në qasje të dokumenteve zyrtare, pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë, çështjet gjinore, foli drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, z. Ibrahim Shala. Studentët me interesim përcollën ligjëratën, si dhe parashtruan shumë pyetje lidhur me të ardhmen e FSK-së, FAK-un, menaxhimin e dokumenteve arkivore, transparencën, qasjen në dokumente zyrtare, etj.

Kadetët e QSU-së kryejnë trajnimin semestral 2017



Kadetët e Qendrës për Studime Universitare (QSU) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë(FSK), më 20 janar 2017, përfunduan trajnimin semestral 2017 (ushtrimin fushor), i cili filloi me datë 10 janar dhe u realizua në lokacionet: Matiqan dhe në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë.

Kjo fazë e trajnimit, ku ishin të përfshirë të gjithë kadetët e QSU-së, ishte fokusuar më shumë në procedurat e udhëheqjes dhe të menaxhimit të trupave, përgatitjen dhe zbatimin e urdhrave operativë, formacionet dhe teknikat e lëvizjes me skuadër, parullat e rikonicionit dhe ato luftarake, drillet e betejës, navigimin tokësor ditën dhe natën, pikat e kontrollit etj. Gjatë realizimit të këtij ushtrimi, kadetët i vizitoi komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili vlerësoi lart gatishmërinë e stafit të QSU-së për t'i përgatitur kadetët e kësaj qendre me sa më shumë njohuri të reja ushtarake.

Gjeneral Cikaqi tha se ndihet mjaft i kënaqur me angazhimin e stafit dhe me kadetët e QSU-së. Ai ndër të tjera u shpreh: "Shfrytëzoni këtë kohë për të fituar njohuri të cilat do t'ju përcjellin gjatë tërë karrierës suaj. Ushtrimet fushore janë pjesë e jetës ushtarake, të cilat e bëjnë jetën në uniformë pak më të vështirë, por mjaft atraktive, duke të sfiduar nganjëherë, por gjithsesi të bënë të ndjehesh krenar. Andaj ju përgëzoj për këtë angazhim tuajin dhe ju dëshiroj suksese në punë dhe karrierë". Ndërsa, komandanti i QSU major Avni Kiqina bëri një prezantim lidhur me qëllimin e këtij trajnimi. Më pas major Kiqina e njoftoi gjeneralin Cikaqi edhe me rrjedhën e ushtrimit në vazhdimësi, ndërsa kadetët prezantuan detyrat dhe përgjegjësitë sipas skuadrave të tyre. Trajnimi dhjetë ditor, semestral, u realizua me sukses duke iu përshtatur kushteve të kazermës dhe të natyrë.

FSK në punëtorinë ndërkombëtare "Menaxhimi i sigurt i municioneve" në Gjenevë

Drejtori i Departamentit për Operacione dhe Trajnime në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), gjeneral brigade Nazmi Brahimaj dhe drejtori i Qendrës Koordinuese për Deminim në MFSK, z. Ahmet Sallova më 8-9 dhjetor 2016, morrën pjesë në punëtorinë ndërkombëtare të organizuar nga Departamenti Federal i Mbrojtjes të Zvicrës në Gjenevë, lidhur me temën 'Menaxhimi i Sigurt i Municioneve'. Në këtë punëtori ku po marrin pjesë përfaqësues të 68 shteteve të botes, në mesin e tyre edhe përfaqësuesit e MFSK/FSK, drejtori i departamentit për Operacione dhe Trajnime gjeneral Brahimaj dhe drejtori i Qendrës Koordinuese për Deminim zoti Sallova, po diskutohet për menaxhimin e sigurt të municioneve dhe parandalimin e rritjes së panevojshme të tyre duke marrë parasysh rrezikun për eksplodimet e paparashikuara që vazhdojnë të rrisin rreziqet dhe shqetësimet humanitare. Menaxhimi jo i sigurt i municioneve rezervë paraqet kërcenim për shoqërinë dhe shtetin si dhe mund të keqpërdoret për konflikte të armatosura, krim të organizuar dhe terrorizëm. Gjithashtu, në këtë punëtori u diskutua edhe për sigurimin e një platforme për menaxhimin e sigurt të municioneve si dhe sfidat në implementimin e rregulloreve ndërkombëtare dhe zhvillimin e elementeve konkrete, adresimin për menaxhim të sigurt të municioneve. Gjatë simpoziumit, delegacionit të Kosovë-FSK-së, përfaqësues të organizatave të ndryshme u kanë ofruar mbështetje në ndërtimin e depove të municioneve si dhe përgatitjen e rregulloreve të ndryshme për deponim.



FSK-ja mban ligjërata për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve shpërthyese

Kompania e Deminimit e FSK-së, sezonin dimëror po e shfrytëzon për mbajtjen e ligjëratave për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve shpërthyese, siç janë: minat, bombat, kasetë bomba, etj. Më 17 janar instruktorët e Kompanisë së Deminimit mbajtën ligjërata në dy shkolla të Komunës së Parteshit për nxënësit e komunitetit serb. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim dhe bashkërendim të Departamentit për Bashkëpunim Civili-Ushtarak të MFSK-së me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Parteshit, përkatësisht drejtoreshën e kësaj drejtorie, znj. Vesna Jovanoviq. Instruktorët e FSK-së ligjëratat për vetëdijesimin e nxënësve në Komunën e Parteshit i mbajtën në dy shkolla, në shkollën "Miladin Popoviq" në Pasjan dhe në shkollën "Dosidej Obradoviq" në Partesh. Numri i nxënëseve të cilët përcollën këto ligjërata ishte solid, ndërsa pritja nga ana e personelit nga të dyja shkollat dhe interesimi i nxënësve për t'u pajisur me informacione ishte i mirë. Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, z. Hajrush Kurtaj, njofton se ligjëratat për vetëdijesimin e nxënësve nga mjetet e pashpërthyera të organizuara nga instruktorët e Kompanisë së Deminimit të FSK-së, për sezonin dimëror, kanë filluar më 16 janar dhe do të vazhdojnë të mbahen deri më 9 mars 2017, atëherë kur edhe fillon sezoni veror. Ky aktivitet do të zhvillohet nëpër shumë shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës dhe ka për qëllim pajisjen e nxënësve me njohuri rreth mjeteve të pashpërthyera dhe të rrezikshme për jetën. Zoti Kurtaj këto ligjërata i vlerësoi si mjaft të rëndësishme për nxënësit dhe njëherësh falënderoi Drejtorinë e Arsimit në Partesh për bashkëpunimin me FSK-në.



Njësitet e FSK-së pastrojnë rrugët nga dëbora



Njësitet e specializuara të xhenios të Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjatë këtij muaji, morën pjesë në pastrimin e shumë rrugëve në disa vendbanime të Kosovës, të cilat kishin mbetur të bllokuara si pasojë e reshjeve të mëdha të borës dhe temperaturave të ulëta. Me kërkesë të Qendrës së Situatave dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave të Kosovës, njësitet e FSK-së kanë dalë në terren dhe kanë zhbllokuar disa rrugë të bllokuara nga bora në komunat Artanë, Dragashit, në fshatin Jezerc të Ferizajt dhe në fshatin Berishë. Në Komunën e Artanës janë pastruar rrugët e disa fshatrave të kësaj komune të banuar kryesisht me popullatë të përzierë shqiptare dhe serbe. Po ashtu është pastruar edhe rruga për fshatin Berishë, ku janë të vendosura antenat dhe stabilimentet transmetuese. Kurse në fshatin Jezerc, bora kishte bllokuar rrugët, ku trashësia e saj, arrinte edhe deri në tri metra. Njësitet e FSK-së, vazhdojnë të jenë në gatishmëri, në rast të kërkesës nga Qendra e Situatave të Qeverisë së Kosovës, që në çfarëdo situate të intervenojnë në pastrimin e rrugëve për t'iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës.



FSK-ja, trajnime për instruktorë në artet marciale

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë ka filluar trajnimi fizik për instruktor në lëmin e arteve marciale, i cili trajnim është duke u realizuar nga një ekip mobil i instruktorëve të Marinës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Është hera e parë që për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) po mbahet një trajnim i këtij lloji. I gjithë plani dhe programi i trajnimit është adaptuar nga Programi i Arteve Marciale të Marinës së SHBA-së. Dhjetë pjesëtarët, të cilët janë duke e ndjekur trajnimin, janë përzgjedhur nga njësitet e ndryshme të FSK-së dhe janë mjeshtër në sporte të ndryshme luftarake. Nga këta pjesëtarë presim që pas përfundimit të këtij trajnimi më 10 shkurt të licencohen për instruktorë të arteve marciale, ku më pastaj do të organizojnë trajnime të tilla në të gjitha njësitet e FSK-së. Qëllimi i këtij trajnimi është që krahas ngritjes profesionale në fushat e tjera, pjesëtarët e FSK-së të jenë të përgatitur edhe fizikisht në përballimin e çdo lloj sfide, qoftë fizike apo psikike.

Me sportistët e dalluar të FSK-së

Togeri Getoar Rexhepi, kampion i shumëfishtë i Kosovës në karate

Getoar Rexhepi është pjesëtar i Batalionit të Tretë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, i dalë nga Qendra për Studime Universitare e FSK-së. Dëshira për tu marrë me artet marciale (luftarake) i lindi si nxënës i shkollës fillore. Getoari dhjetë herë radhazi fitoi medaljen e artë dhe ishte kampion i shumëfishë i Kosovës në Karate. Getoar Rexhepi u lind në Prishtinë, më 16 tetor 1988,



ku kreu shkollimin fillor në Shkollën Fillore "Meto Bajraktari" dhe atë të mesmen në Gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë, me sukses të shkëlqyeshëm. Në klasën e tretë fillore, shpallet nxënësi më i mirë i gjeneratës. Për suksesin dhe të ardhmen e tij të ndritur, kishte shkruar revista e shkollës "Filloristi". Në vitin 2007, Getoari regjistrohet në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, programi 4 vjeçar i kadetëve për oficer dhe Fakultetin për Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci, ku më 2011-të i kreu me sukses, ku merr thirrjen; oficer i Forcës së Sigurisë të Kosovës me gradën-nëntoger. Dëshira për artet marciale, gjegjësisht për sportin e karatesë iu plotësua me regjistrimin në klubin e karatesë "Studenti" në Prishtinë, në vitin 2001. Falë vullnetit, punës dhe trajnimeve të çelikta, Getoari arrin që, në vitin 2002, të shpallet më i miri, në kategorinë e grupmoshës së tij, kategorinë 1988, dhe të stoliset me medaljen e artë. Gjatë viteve vijuese, Getoari ia arriti qëllimit që i kishte parashtrua vetës, në perfeksionin dhe ngritjen e nivelit të karatesë, falë vendosmërisë dhe punës së palodhur dhe ndihmës së mjeshtër të karatesë kosovare; Sensei Sylejman Jetullahu - 5 DAN, Sensei Safet Ramadani-5 DAN (gjyqtar ndërkombëtar në Federatën botërore) dhe Bejar Fazliu 7 DAN, mjeshtër i karatesë tradicionale që aktualisht jeton dhe vepron në Pensilvania-SHBA. Getoari që nga viti 2002-2010, shpallet më i miri, duke e zënë vendin e parë në Kampionatin e Kosovës në Karate. Disa herë radhazi shpallet ndër dhjetë sportistët e vitit nga Federata e karatesë së Kosovës. Në vitin 2006, karrierën e vazhdoi në klubin e karatesë "Iliria" në Prishtinë, që për atë kohë, ishte klubi më i suksesshëm në nivel vendi dhe atë ndërkombëtarë. Edhe në klubin e ri, Getoari shpërtheu me sukseset si në arenën vendore, mbarëkombëtare dhe në turnetë ndërkombëtare. Gjatë viteve 2005- 2006, në Kampionatin Mbarëkombëtar të organizuar nga Federata Shqiptare e Karatesë, mbajtur në Tiranë, shpallet kampion mbarëkombëtar në kategorinë absolute-senior, kurse në vitin 2014, zuri vendin e dytë në Kampionatin e Karatesë në nivel të Republikës së Kosovës. Getoari mori pjesë në shumë turne me karakter kombëtar, mbarëkombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, ku nderohet gjithnjë me vendin e parë, duke u nderuar edhe me medaljen e artë. Në turneun memorial ndërkombëtar "Zahir Pajaziti", "Xhevat Makolli", "Rrahim Curri e Behar Begolli" ku pjesëmarrës ishin edhe klube nga shtetet e rajonit, Getoari shpallet kampion i turneut. Edhe në Turnetë dhe Kupat Ndërkombëtare të Karatesë, mbajtur në rajon, Getoari ka fituar kupa dhe medalje të arta, si në garat: Kupa e Gostivarit, Struga Open, Yoshitaka Open, Solidarnost Open, "Dëshmorët e Kombit" etj. Gjithashtu është edhe kampion i turneve të karatesë (tradicional) "Besimi Mala-Murrizi", "Katana Open" etj. Në vitin



2014, shpallet kampion i Republikës së Shqipërisë në Karate, kategoria e seniorëve. Në vitin 2007, për merita të jashtëzakonshme dhënë sportit shqiptar, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Alfred Moisiu e dekreton-duke i dhënë nënshtetësinë shqiptare. Toger Getoar Rexhepi në kuadër të Forcës së Sigurisë të Kosovës dallohet me angazhimin, profesionalizimin dhe disiplinën që ka. Ai gjithmonë është përkrahë ushtarëve, duke i ndihmuar, në kryerjen e detyrave të përgjithshme si në trajnime, ushtrime etj., me qëllim të përfitimit të njohurive profesionale. Për togerin, flasin shokët në superlativ. Kontributi i tij, gjatë trajnimeve dhe ushtrimeve të përgjithshme dhe atyre të veçanta është mjaftë i madh. Ndërsa, synimi i tij, është, që në të ardhmen të hapë një shkollë të arteve luftarake me qëllim të ngritjes së njohurive tek të rinjtë e Kosovës. Getoar Rexhepi, aktualisht e ka Brezin e Zi, shkalla e Tretë (3 DAN). Getoar Rexhepi, që nga viti 2011, shërben në Batalionin e Tretë të Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë, me gradën ushtarake Toger.



FORCA JONË

□□□ Viti VI □ Nr. 55 □Mars 2017 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Ministri Haki Demolli zhvilloi takim me Sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jans Stoltenberg

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli dhe Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Rrahman Rama, më 3 shkurt 2017, zhvilluan një takim të përbashkët me Sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jans Stoltenberg. Në takim, u bisedua për situatën e sigurisë në vendin tonë, hapat që duhet ndërmarrë lidhur me ruajtjen e paqes dhe sigurisë, stabilitetit të Kosovës, si dhe zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.Nga ana e tij, ministri Demolli e njoftoi Sekretarin e NATO-s, Jans Stoltenberg mbi zhvillimin dhe profesionalizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, avancimin e saj në drejtim të krijimit-



përmbushjes së misionit të saj në mbështetje të institucioneve dhe qytetarëve të vendit si dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për përfshirjen e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Gjithashtu, ministri Demolli duke shprehur mirënjohje për angazhimin e NATO-s për paqe në Kosovë përmes trupave të KFOR-it, tha se aktualisht Republika e Kosovës është duke u përpjekur seriozisht që të zhvillojë dhe konsolidojë mekanizmat e saj të sigurisë për të ardhmen, gjithnjë bazuar në konsensus politik të brendshëm dhe në koordinim me faktorin ndërkombëtar.Nga ana e tij, Sekretari i përgjithshëm i Aleancës, z. Stoltenberg deklaroi një mbështetje të pa rezervë për FSK-në përmes Ekipit Këshillues ndërlidhës të NATO-s (EKNN), misionin dhe kapaciteteve të saj, duke shprehur konsideratë të lartë për profesionalizmin dhe angazhimin e saj të treguar deri më tani.

Ministri Haki Demolli priti z. Matthew Palmer drejtor për Çështje të Evropës në Departamentin Amerikan të Shtetit



Më 14 shkurt 2017,ministrii Forcës së Sigurisë të Kosovës, zotëri Haki Demolli, priti në takim një delegacion nga Departamenti Amerikan i Shtetit në krye me zotëri Matthew Palmer, drejtor për Çështje të Evropës Qendrore dhe Jugore.Në takimme delegacionin amerikan ishin prezent edhe zv. ministri Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shefi i Kabinetit Latif Leka, ku u bisedua për zhvillimet politike dhe të sigurisë në vend, procesin e transformimit të FSK-së në FAK, si dhe rreth bashkëpunimit dypalësh të Kosovës me mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë, me partnerët strategjikë dhe me shtetet tjera partnere të vendit tonë. Ministri Demolli e njoftoi z. Palmerinedhe për situatën e sigurisë në vend, zhvillimin e kapaciteteve të FSK-së dhe zhvillimet rreth procesit të saj të transformimit, planet e Ministrisë dhe Qeverisë lidhur me procesin e transformimit, gatishmërinë për transparencë në këtë proces si dhe domosdoshmërinë e koordinimit me NATO-n, partnerët strategjikë (SHBA, Gjermani, Britani e Madhe, etj.) dhe hapat e mëtejmë të rrumbullakimit të këtij procesi mjaft të rëndësishëm të shtet-ndërtimit të Kosovës. Ministri Demolli, gjithashtu tha se Kosova synon ndërtimin e një force shumetnike, mbrojtëse dhe e gatshme për t'i kontribuar paqes në rajon dhe më gjerë. Zoti Demolli shprehu mirënjohjen e tij për angazhimin e NATO-s në ruajtjen e paqes në Kosovë përmes trupave të KFOR-it. Ai po ashtu tha se, aktualisht Republika e Kosovës është duke u përpjekur seriozisht që të zhvillojë dhe konsolidojë mekanizmat e saj të sigurisë për të ardhmen, gjithnjë bazuar në konsensus politik të brendshëm dhe në koordinim me faktorin ndërkombëtar.

Nga ana e tij, MatthewPalmer shprehu mbështetje të plotë për rrugën euroatlantike të Kosovës. SHBA-të mbështetin transformimin e FSK-së në FAK dhe angazhohet që ky proces të jetë i mbështetur nga të gjitha palët në Parlamentin e Kosovës.

Komandanti i FSK-së, raportoi në Komitetin për Operacione dhe Politika të NATO-s në Bruksel

Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant RrahmanRama, më 21 shkurt 2017, së bashku me drejtorin e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në, gjeneral brigade DietmarMosmann, qëndruan për vizitë dy ditore zyrtare në Shtabin e NATO-s në Bruksel, përkatësisht në Komitetin për Operacione dhe Politika. Komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant RrahmanRama para këtij komisioni raportoi për bashkëpunimin me NALT-in dhe NATO-n, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së gjatë vitit 2016 dhe për vizionin dhe objektivat e FSK-së për të ardhmen. Ndërsa, gjenerali Dietmar Mosmmanraportoi për zhvillimin e NALT-it, mbështetjen dhe bashkëpunimin me FSK-në, si dhe për detyrat në të ardhmen. Ndërkaq, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka zhvilluar takime edhe me disa përfaqësues të NATO-s dhe me kryesuesin e takimit të Komitetit për Operacione dhe Politika, z. MichelSoula. Prezantimet e gjeneral Ramës dhe gjeneral Mosmann u mirëpritën nga të pranishmit në komitet, madje ata edhe u inkurajuan nga përfaqësuesit e këtij komitetit për të arriturat e deritashme dhe për vizionin e tyre për zhvillimin e FSK-së në ardhmen.



Ambasadori i SHBA-ve Greg Delawie ligjëroi para kadetëve të FSK-së

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, z. GregDelawie, më 3 shkurt 2017, vizitoi kazermën "Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, ku u prit nga komandanti i saj, gjenerallejtënant RrahmanRama. Me këtë rast gjenerali RrahmanRama e falënderoi ambasadorin e SHBA-ve, për ndihmën e pakursyer që SHBA-të po japin për FSK-në, si dhe e njoftoi ambasadorin Delawie, me angazhimin e FSK-së, si dhe bashkëpunimin me instruktorë të Gardës Kombëtare të Ajovës-SHBA-ve, gjatë trajnimeve që po zhvillohen aktualisht në FSK.Gjatë vizitës në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, komandant i QSU-së, majori AvniKiqina, përmes një prezantimi e njoftoi ambasadorin GregDelawie, me aktivitet e saj; shkollimet dhe trajnimet profesionale që përgatiten në Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së.Me këtë rast, ambasadori Delawie shprehu kënaqësinë që gjendet në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, si dhe përgëzoi stafin dhe kadetët për arritjet e përgjithshme. Ai më pas, para kadetëve të FSK-së, mbajti një ligjëratë të përgjithshme që në fokus kishte të bënte korrupsioni si një e keqe e shoqërisë në përgjithësi. Me këtë problem po merren jo vetëm shtetet në zhvillim por edhe ato të zhvilluara. Interesimi i kadetëve rreth kësaj teme ishte i madh, ku shumë nga ta i parashtruan pyetje ambasadorit Greg Delawie.



Ministri Haki Demolli priti një delegacion ushtarakësh nga Franca të kryesuar nga ambasadori i Francës Didier Chabert

Një delegacion nga Instituti i Studimeve të Larta të Sigurisë Kombëtare të Ministrisë së Mbrojtjes të Francës, më 24 shkurt 2017, qëndroi për një vizitë zyrtare në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës. "Mbështetja dhe përkrahja e Francës për Kosovën në drejtim të ndërtimit dhe funksionalizimit të sektorit të sigurisë, me theks të veçantë transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, është më së i nevojshëm, nëpërmjet mekanizmave të fuqishëm që posedon aktualisht Franca, kudo në organizatat me peshë të organizmave evropiane e më gjerë". Kështu u shpreh ministri i FSK-së, Haki Demolli, gjatë takimit me ambasadorin e ri në detyrë të Republikës së Francës në Republikën e Kosovës, Didier Chabert dhe gjeneralin Daniel Argenson udhëheqës i delegacionit. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe zëvendësministri i MFSK-së, Muhamet



Latifi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Ministri Haki Demolli ka çmuar lart kontributin e kontingjentit të Francës në kuadër të KFOR-it, por edhe interesimin dhe angazhimin që ka treguar Franca në vazhdimësi për Kosovën. Ai po ashtu shprehu para tyre kërkesën që ky të mos mbetet takimi i vetëm, por të vazhdohet me takime konkrete edhe në të ardhmen në të mirë të bashkëpunimit të dyanshëm. Ndërkaq, ambasadori i Francës në Prishtinë dhe gjenerali Argenson u shprehen jashtëzakonisht të interesuar për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen ndërmjet dy vendeve dhe dy forcave tona.

Më pastaj delegacioni nga Instituti i Studimeve të Larta të Sigurisë Kombëtare të Ministrisë së Mbrojtjes të Francës vazhdoi takimin e përbashkët në sallën e konferencave, ku drejtori i Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim, kolonel Agron Bajrami, përmes një prezantimi i njoftoi mysafirët për misionin, strukturën, shkollimet, trajnimet si dhe për procesin që ka të bëjë me transformimin e FSK-së.

Një delegacion ushtarakësh nga Gjermania u prit nga ministri Haki Demolli dhe stafi i FSK-së

Në mjediset e Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, më 21 shkurt 2017, qëndroi një delegacion ushtarakësh-ekspertë nga Qendra për Zhvillim të Lidershipit dhe Edukim Civil të Forcave të Armatosura të Gjermanisë, të prirë nga komandanti Volker Brasen dhe nënkolonel Martin Gerster. Delegacioni gjermanë u prit, në vizita të ndara, nga ministri Haki Demolli, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj dhe drejtori i Drejtorisë së Operacioneve në MFSK-së, gjeneral brigade Zymer Halimi. Ministri Demolli e falënderoi delegacionin ushtarak gjerman për ndihmën e pakursyer që Gjermania dhe Forcat e saj Ushtarake i kanë dhënë ndër vite FSK-së për edukimin dhe trajnimin ushtarak, si dhe për mbështetjen e dhënë për integrimin e Kosovës në organizmat ndërkombëtarë. Ministri po ashtu i njoftoi ekspertët ushtarakë edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së si; bashkëpunimin ndërkombëtar,



arritjet profesionale, e në veçanti lidhur me procesin e transformimit të FSK-së në FAK.

Ministri i FSK-së i shprehu dëshirën delegacionit gjerman për ta rritur bashkëpunimin edhe në fusha tjera me interes të dyanshëm. Më pas delegacioni i ekspertëve ushtarak u prit edhe nga sekretari i përgjithshëm i FSK-së, Shkëlzen Sylaj dhe drejtori i Drejtorisë së Operacioneve në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi, të cilët, përveç tjerash, falënderuan delegacionin ushtarak gjerman për ndihmën e vazhdueshme që ata po japin në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së.Vlen të cekët se delegacioni ushtarak gjerman, në bazë të Planit të bashkëpunimit dypalësh që ka MFSK-ja me Gjermaninë, që nga data 20 shkurt 2017 ka filluar mbajtjen e seminarit me temë "Forcat e Armatosura në Demokraci" i cili do të vazhdojë deri më 24 shkurt 2017. Në fund, ekspertët ushtarakë gjermanë falënderuan ministrin Demolli, sekretarin Sylaj dhe gjeneral Halimin për pritjen dhe njëherazi premtuan thellimin e bashkëpunimi edhe në të ardhmen në mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Gjermanisë.

Ministri Haki Demolli falënderoi komandantin e Kontingjentit të KFOR-it turk kolonelin Tavazar

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli, më 15 shkurt 2017, priti në takim komandantin e Detashmentit të bashkuar regjional jugor të KFOR-it, kolonel Mustafa Ihsan Tavazar, njëherësh edhe komandanti i Kontingjentit turk të KFOR-it.Në takimin e përbashkët të ministrit Demolli dhe kolonelit Tavazar u bisedua për gjendjen e sigurisë në vend, zhvillimin e FSK-së dhe angazhimin e KFOR-i në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend, me theks të veçantë për kontributin e vazhdueshëm të Kontingjentit ushtarak turk në kuadër të KFOR-it, i cili në vazhdimësi ka përkrahur avancimin profesional dhe zhvillimin e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.Nga ana e tij, ministri Demolli duke i uruar detyrën e re, e ka falënderuar kolonelin Tavazar për mbështetjen që shteti i Turqisë, Ministria e



Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të saj kanë dhënë për Kosovën dhe FSK-në, përmes angazhimit të pakursyer të ekipeve trajnuese të ushtarakëve turq.Gjithashtu edhe kolonel Mustafa Ihsan Tavazar ka shprehur gatishmërinë që bashkëpunimi me MFSK-në dhe FSK-në të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen, njëkohësisht Ai ri përsëriti përcaktimin e Turqisë që të mbështetës Kosovën në ngritjen dhe avancimin e mekanizmave të saj të sigurisë.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ambasadori i Malit të Zi në Kosovë Ferhat Dinosha pritet nga ministri i MFSK-së Haki Demolli




Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli, më 1 shkurt 2017, priti në takim, për herë të parë, ambasadorin fuqiplotë të Republikës së Malit të Zi në Republikën e Kosovës, zotëri FerhatDinosha.Gjatë takimit, ministri Demolli duke i uruar detyrën e re diplomatit nga Mali i Zi, e njoftoi edhe me misionin, detyrat dhe aktivitetet e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë; për zhvillimet në MFSK dhe FSK, si dhe për bashkëpunimin e suksesshëm ndërkombëtar të MFSK dhe FSK me partnerët strategjikë në rajon dhe më gjerë. Pastaj, Ministri Demolli u shpreh se marrëdhëniet e mira fqinjësore ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, përkatësisht Ministrisë për FSK dhe Ministrisë së Mbrojtjes duhet të vazhdojnë të kultivohen edhe më tutje, si marrëdhënie ndërmjet dy shteteve dhe institucioneve që aspirojnë integrimin në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin në NATO.Gjithashtu, Ministri Demolli foli edhe lidhur me procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, për synimet e Kosovës për anëtarësim në NATO, Bashkim Evropian, si dhe në iniciativat rajonale, evropiane dhe globale. Duke ditur që Mali i Zi është pothuajse një hap përpara, ministri i FSK-së anëtarësimin e pritur të Malit të Zi në NATO e cilësoj si një sukses edhe të rajonit në përgjithësi. Nga ana e tij, ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, zotëri FerhatDinosha shprehu përkrahjen e pa rezerve për Kosovën në rrugën e saj evropiane, si dhe u shpreh se marrëdhënie e mira në mes të Malit të Zi dhe Kosovës do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, duke qenë se paqja dhe prosperitetit i shtetit të Kosovës është edhe në interes të rajonit në përgjithësi.

Ministri Haki Demolli mori pjesë në Samitin e kryetarëve të komisioneve për punë të jashtme



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, zotëri Haki Demolli, më 21 shkurt 2017, mori pjesë në punimet e Samitit të kryetarëve të komisioneve për punë të jashtme, organizuar nga Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës, me temë: ,,E ardhmja e Ballkanit në Evropë dhe integrimet euroatlantike".Gjatë zhvillimit të punimeve të Samitit, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Haki Demolli prezantoi temën: "Thellimi i bashkëpunimit në mes të vendeve të Ballkanit drejt integrimit në organizata ndërkombëtare/ tejkalimi i barrierave politike në rajon", ku u fokusua në dy çështje mjaft të rëndësishme siç janë: Bashkëpunimi dypalësh dhe regjional i MFSK-së, si faktor i rëndësishëm për integrime euroatlantike dhe bashkëpunimi ndërmjet MFSK-së dhe mekanizmave të NATO-s.
Më tej, Ministri Demolli tha se: ,,është fakt i pakontestueshëm së Republika e Kosovës si shtet i pavarur dhe relativisht i ri, mund të jetë e sigurt, e qetë dhe e orientuar drejt zhvillimit dhe prosperitetit ekonomik, vetëm: po qe se rajoni, pra shtetet e Ballkanit dhe Evropës janë të sigurta dhe po qe se këto mekanizma janë në rrugë të përbashkët drejt anëtarësimit dhe integrimit në organizata dhe mekanizma rajonalë dhe ndërkombëtarë". Gjithashtu, ministri i FSK-së theksoi faktin se Republika e Kosovës ka synim të saj strategjik anëtarësimin në strukturat e Bashkimit Evropian dhe të NATO-s, por edhe në mekanizmat tjerë rajonalë dhe ndërkombëtarë të sigurisë. Ky synim shtoi ministri Demolli është i drejtë, i arsyeshëm dhe i sinqertë, për faktin se Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjërit prej shteteve fqinje, andaj natyrisht që pret edhe prej vendeve të rajonit të zhvillojnë dhe ndjekin një politikë të tillë, e cila është konstruktive dhe nën frymën e bashkëpunimit dhe integrimeve rajonale dhe ndërkombëtare.Në fund, ministri Haki Demolli tha se, Republika e Kosovës do të vazhdojë të punojë për sigurinë e saj të brendshme dhe të jashtme, duke shtuar se ndërtimi i Forcave të Armatosura do të ndihmojë në arritjen e interesave dhe objektivat e sigurisë kombëtare. Përafrimi drejt anëtarësimit në NATO do të ndihmojë shumë Kosovën dhe Forcat e saj të Armatosura që të ndërtohen mbi parimet dhe standardet më të larta të vendeve të Aleancës Veri-Atlantike.

Marrëveshje bashkëpunimi në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë



Drejtori i Departamentit për Politika dhe Plane në Ministrinë e FSK-së, z. Faruk Geci, më 1 shkurt 2017, është pritur në një takim pune nga drejtori i Politikave të Mbrojtjes të Ministrisë së Mbrojtjes së Sllovenisë në Lubjanë, z. Mishmas.Me këtë rast, të dy drejtorët nënshkruan Planin dypalësh të bashkëpunimit midis Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë dhe Ministrisë për FSK-në për vitin 2017, i cili plan parasheh një mori aktivitetesh në fushën e shkollimit, trajnimeve të ndryshme si dhe pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrime të përbashkëta. Të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi i mirë të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke i shtuar aktivitetet gjatë viteve në vijim.Gjatë qëndrimit në Sllloveni, drejtori Geci me homologët sllovenë kanë vizituar edhe Qendrën e Gjuhëve të huaja, ku janë pritur nga udhëheqësja e saj, znj. BrankaPetek, e cila mysafirët i ka njoftuar me punën profesionale dhe të arriturat e përgjithshme të kësaj qendre. Të dy palët kanë biseduar edhe për format e mundshme të bashkëpunimit lidhur me shkollimin e pjesëtarëve të FSK-së në këtë qendër. Sipas marrëveshjes, për këtë vit, katër pjesëtarë të MFSK/FSK-së do t'i ndjekin kurset e avancuara të gjuhës angleze në Sllloveni.

Në MFSK mbahet takimi i dytë i grave të sektorit të sigurisë

Më 16 shkurt 2017, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, u mbajt takim i dytë i përfaqësuesve të grave të cilët punojnë në sektorin e sigurisë të Kosovës dhe të organizatave të shoqërisë civile. Qëllimi i mbajtjes së këtij takimi është bashkërendimi i aktiviteteve dhe objektivave në fushën e mbështetjes së gruas në sektorin e sigurisë, nga ana e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.Në këtë takim të sigurisë, pos grave nga Ministria e FSK-së dhe FSK-ja, morën pjesë edhe gratë nga Policia e Kosovës, nga Ministria e Punëve të Brendshme, nga Kuvendi i Kosovës, Organizata e Shoqërisë Civile, KIPRED, OSBE, DCAF, UNWOMEN, e të tjera.Takimin e sotëm e hapi koordinatorja e Njësisë për të Drejtat e Njeriut të MFSK-së, z. Halime Morina e cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi për pjesëmarrjen në këtë takim të sigurisë.Në takimin e grave pjesëmarrëse prezantuan edhe Ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli, sekretari i përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj dhe GanimeteMusliu, deputete e Parlamentit të Kosovës-Komisioni për punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së.Ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli, me këtë rast, përshëndeti gratë pjesëmarrës si dhe deputeten Ganimete Musliu, duke përkrahur iniciativën që gratë janë duke e bërë, sa i përketë rolit të grave në fushën e sigurisë.
Ai tha se: "jemi përkushtuar ne si ministri, që ta avancojmë rolin e femrës në Ministri dhe FSK, në fushën e sigurisë. Ai tha se: "ne mburremi me vetë faktin për rolin e grave që kanë në Ministri dhe FSK, respektimin e tyre si dhe me multietnicitetin në kuadër të MFSK-së dhe FSK-së".



Nënkryetarja e Komisionit për Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Ganimete Musliu vizitoi KDS-në

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, ishte për vizitë deputetja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, njëherësh nënkryetare e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së znjsh. GanimeteMusliu, e cila u prit nga zëvendëskomandanti i KDS kolonel Irfete Spahiu dhe stafi i saj. Zëvendëskomandant i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu pasi i uroi mirëseardhje deputetes Musliu e njoftoi shkurtimisht edhe me misionin dhe të arriturat e KDS -së gjatë periudhës kohore 2009-2017. Kolonel Spahiu gjithashtu foli edhe për angazhimin e femrave në të gjitha nivelet dhe pozitat në KDS, duke vlerësuar lart rolin e



tyre, pa qenë fare të privilegjuara por të trajtuara njësoj me pjesëtarët tjerë. Deputetja Musliu në cilësinë e nënkryetares së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, tha se ndjehet mjaft e lumtur me arritjet e KDS si një institucion edukativ-arsimor i FSK-së. Ajo po ashtu nënvizoi faktin se Kuvend i Republikës së Kosovës është duke punuar në vazhdimësi për shndërrimin e FSK-së në Forca të Armatosura.Me pas deputetja Musliu zhvilloi një takim me të gjitha femrat të cilat punojnë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, ku bashkërisht diskutuan për format dhe mënyrat e mbështetjes dhe fuqizimit të pozitës së femrës. Në fund kolonel Spahiu në emër të pjesëtarëve të KDS falënderoi deputeten Musliu për vizitën që i bëri KDS-së.

Ministri i MFSK-së, pritet me nderime të larta ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë

Nënshkruhet Plani i Bashkëpunimit dypalësh për vitin 2017 në mes MFSK-së dhe MMRSH-së




Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Haki Demolli, më 13 shkurt 2017, u prit me nderime të larta ushtarake në vizitë zyrtare në Tiranë, nga ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli. Të dy ministrat fillimisht, diskutuan për çështje të interesit të përbashkët dhe për Planin e Bashkëpunimit Dypalësh në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, Ministri Demolli dhe ministrja Kodheli, biseduan edhe për zhvillimet e fundit të sigurisë në Republikën e Kosovës dhe në veçanti për situatën e krijuar në kufijtë veriorë të saj. Në takim u fol gjithashtu edhe për dyfishimin e numrit të ushtarakëve shqiptarë që janë pjesë e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR-it.

Po ashtu, në takim u bisedua edhe për vizitën e fundit të z. Stoltenberg, respektivisht sekretarit të NATO-s që i bëri Kosovës, ditët e kaluara, ku u theksua nga ana e z. Stoltenberg përkrahja e vazhdueshme, të cilën po jep NATO në sigurimin e paqes në Kosovë dhe u theksua se edhe në të ardhmen trupat e KFOR-it do të qëndrojnë dhe do t'i ofrojnë një siguri të plotë Republikës së Kosovës. Pas takimit mes dy ministrive u firmos edhe Plani i Bashkëpunimit Dypalësh për vitin 2017, i cili fokusohet në stërvitjet dhe trajnimet e përbashkëta.Nga ana e tij, Ministri Haki Demolli, para medieve në Tiranë, tha se ka falënderuar ministren e Republikës së Shqipërisë shtet, i cili në vazhdimësi është duke përkrahur paqen dhe sigurinë në Kosovë si edhe është duke përkrahur zhvillimin dhe avancimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës. Më tej, Ministri Demolli tha se: ,,Qëllimi kryesor i vizitës sonë respektivisht edhe i këtij takimi ishte analizimi dhe vlerësimi i bashkëpunimit të deritanishëm dhe sidomos ishte mundësia e identifikimit të këtij bashkëpunimi për çka të dy palët u pajtuan që edhe në vitet e ardhshme, duke filluar nga viti 2017 e tutje këtë bashkëpunim ta zhvillojmë në të gjitha segmentet e mundshme.

Në fund, ministri i FSK-së, zotëri Haki Demolli tha se bashkëkisht konstatuam që grupet bashkëpunuese të dy ministrive edhe gjatë vitit 2016, kanë realizuar dhe përmbushur të gjitha aktivitetet e planifikuara në planin e veprimit të vitit 2016 si dhe u pajtuam dhe e nënshkruam planin e veprimit për vitin 2017, ku me detaje parashtrohen aktivitetet ndërmjet dy ministrive.

Në përfundim të takimit para përfaqësuesve të mediave, ministrja Kodheli, tha: "me ministrin e Forcës së Sigurisë të Kosovës z. Haki Demolli, zhvilluam një bisedë lidhur me marrëdhëniet dypalëshe, lidhur me situatën në Ballkanin Perëndimor dhe sigurisht me gjithë problematikën e këtyre ditëve të fundit që lidhen ngushtësisht me të ardhmen tonë të përbashkët, me të ardhmen euroatlantike të Kosovës, padyshim me të ardhmen evropiane të Shqipërisë, me forcimin e marrëdhënieve për sa i përket sigurisë së kufijve, sigurisht situatën e krijuar në kufijtë veriorë të saj. Historia e Kosovës ka qenë dhe mbetet një histori suksesi e botës demokratike dhe në mënyrë të veçantë e Aleancës së Veriut. Konsolidimi i shtetit të Kosovës dhe paprekshmëria e kufijve kushtetues është në fakt prioritet i axhendës sonë të përbashkët dhe ishte, le të themi, ajo çka në mënyrë eksplicite u bisedua midis nesh dy delegacioneve. Ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, zonja MimiKodhelin ë fund tha se ,,me ministrin Demolli biseduam edhe për bashkëpunimin dypalësh, i cili tashmë është konkret, i hapur dhe i zhveshur nga çdo procedurë burokratike. Kemi firmosur planin e Bashkëpunimit për vitin 2017, me synim që aktivitetet e përbashkëta të fokusohen sidomos në stërvitje e trajnime të përbashkëta. Programet mësimore ushtarake të të gjitha niveleve, janë plotësisht të hapura për personelin e Forcës së Sigurisë së Kosovës qytetarëve, qofshin këta të Shqipërisë apo Kosovës. Shqipëria në fakt, shtoi zonja Kodheli, ndjek me vëmendje zhvillimet në Kosovë dhe padyshim në mënyrë të veçantë, dhe marrëdhënia në këtë fushë ka qenë absolutisht frytdhënëse dhe e shkëlqyer". Pjesë e delegacionit të ministrit, gjatë vizitës në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë ishin edhe ambasadori i Republikës së Kosovës, Sylë Ukshini, Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkelzen Sylaj, drejtori i Departamentit për Operacione dhe Trajnime në MFSK, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, atasheu i Mbrojtjes nënkolonel Enver Dugolli, nënkoloneli Ali Krasniqi, drejtori Departamentit për Bashkëpunim e Siguri në MFSK, dhe shefi i kabinetit të Ministrit, z. Latif Leka.





Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë qëndroi për vizitë zyrtare në FSK

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 23 shkurt 2017, priti në vizitë shefin e Shtabit të Ushtrisë të Republikës së Maqedonisë, gjenerallejtënant Metodija Velickovski, në krye të një delegacioni të lartë të Ushtrisë së Maqedonisë.Shefi i Shtabit të Maqedonisë u prit me ceremoni ushtarake nga Njësia Ceremoniale dhe Orkestra Frymore e FSK-së.Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe ministri Haki Demolli, ku ishte edhe zëvendësministri Muhamet Latifi, zhvilluan takime të ndara me shefin e Ushtrisë së Maqedonisë, gjeneralin Velickovski, të cilin e falënderuan për bashkëpunimin e deritashëm ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë së Maqedonisë, si dhe e njoftuan me të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Po ashtu, ministri dhe komandanti u shprehen se marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë dhe FSK-së me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ushtrinë e Maqedonisë janë në nivel të lartë dhe treguan gatishmëri për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi, duke u bazuar në raportet e mira ekzistuese dhe në konkretizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy forcave dhe të dy vendeve.Përveç takimeve me ministrin Demolli dhe komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën, delegacioni maqedonas në përbërje; ambasadori i Republikës së Maqedonisë në Kosovë, z. Ilija Strashevski, kolonelët Donche Kuzmanov, Zoran Dodevski dhe Goran Nelovski si dhe nënkolonelët Mile Markovski dhe Besnik Emini, zhvilloi një takim edhe me një delegacion të MFSK-së, të përbërë nga gjeneralët; Bashkim Jashari, Zymer Halimi dhe Gëzim Hazrolli, koloneli Fadil Hadërgjonaj dhe nënkolonelët Ali Krasniqi dhe Ismajl Brahimi. Me këtë rast nënkoloneli Agron Bajrami, drejtor i Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim, mbajti një prezantim të shkurtër me temën: "FSK dhe planifikimi për të ardhmen".

Delegacioni nga Maqedonia i shoqëruar nga komandanti i FSK-së gjeneral Rama vizituan Qendrën për Studime Universitare të FSK-së në kazermën "Adem Jashari", ku nga komandanti i saj, major Avni Kiqina, u njoftuan me aktivitetet e kësaj qendre. Dhe me pas vizituan Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, ku u pritën nga komandanti i këtij regjimenti, kolonel Shaip Haziri, i cili përveç tjerash e njoftoi shefin e Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë edhe lidhur me funksionimin dhe kapacitetet e Qendrës Trajnuse të Kërkim-Shpëtimit. Komandanti i FSK-së gjeneral Rama me shefin e Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë, gjeneralin Velickovski dhe së bashku me dy delegacionet, përcollën nga afër demonstrimin e pjesëtarëve të Kërkim-Shpëtimit Urban. Ndërsa shefi i Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë, gjenerallejtënant Metodija Velickovski, shprehu kënaqësi të veçantë për bashkëpunimin e mirë ndërmjet Ushtrisë së Maqedonisë dhe FSK-së si dhe përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për demonstrimin e tyre me sukses.Ai ritheksoi gatishmërinë për bashkëpunim edhe në të ardhmen, qoftë në fushën e arsimimit të kadetëve të FSK-së (nga radhët e komuniteteve) në Akademinë Ushtarake në Shkup, qoftë me pjesëmarrje në trajnime të përbashkëta (kadetët) si në Qendrën e Kërkim- Shpëtimit këtu në Pomozotin apo në Poligonin Ushtarak në Krivollak. Në fund të dy gjeneralët; Rama dhe Velickovski, vlerësuan bashkëpunimin e deritashëm si mjaft të frytshëm dhe theksuan që edhe në të ardhmen ta zgjerojnë këtë bashkëpunim edhe në fusha tjera, duke ndarë eksperienca bashkë.







Ministri Demolli në ceremoninë e rivarrimit të heroit Zahir Pajaziti

Në përvjetorin e 20 të vrasjes së heronjve të kombit: ZahirPajaziti, Edmond Hoxha dhe HakifZejnullahu, më 2 shkurt 2017, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Haki Demollisë bashku me zv. ministrin MuhametLatifi dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRama morën pjesë në ceremoninë e rivarrimit të heroit ZahirPajazitinë Kompleksin Memorial në Turiqicë të Podujevës, ku morën pjesë mijëra qytetarë nga të gjitha trojet shqiptare.



Në ceremoni një fjalë rasti e mbajti ministri i MFSK-së, Haki Demolli, i cili pos tjerash, tha: "Rënia e tyre heroike në janarin e vitit 1997, ia shtoi listës së "janarëve të përgjakshëm" të historisë tonë kombëtare edhe tre dëshmorë të devotshëm, të cilët njëherësh u bënë paralajmërues të luftës së lavdishme çlirimtare të UÇK-së, epilogu i të cilës ishte çlirimi përfundimtar i Kosovës nga okupimi serb" tha në fillim të fjalës së tij, ministri Demolli, për të shtuar se:" Zahiri me shokë u vranë në një periudhë të përgatitjes së patriotëve dhe atdhedashësve kosovarë në krye me Komandantin legjendar Adem Jasharin për të filluar luftën e armatosur ndaj pushtuesit shekullor të Kosovës, duke vlerësuar se liria ishte më e shtrenjtë se jeta, andaj duhej luftuar dhe mposhtur okupatori serb njëherë e përgjithmonë.

Rënia e tyre e hershme, në kohën kur frontit të luftës i nevojiteshin më së shumti, sikurse Zahiri, Hakifi ashtu edhe Edmondi, i bënë ata që të radhiten përkrah bashkëluftëtarëve dhe heronjve të orëve të para të lirisë, siç janë Adem Jashari, Adrian Krasniqi, Luan Haradinaj, SaliÇekaj, e shumë e shumë trima të tjerë të kombit tonë.Lufta e drejtë çlirimtare; pastaj vrasja, torturimi, masakrimi i popullatës civile nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe, trokitën në ndërgjegjen e botës së civilizuar, e cila e krijoi frontin e përbashkët me aleancën më të madhe ushtarake në botë, pra me NATO-n të udhëhequr nga SHBA-të dhe shtetet tjera demokratike të botës, i cili front përfundimisht solli lirinë e Kosovës". Më tej ministri Demolli tha se:"Çlirimi i Kosovës e bëri realitet ëndrrën e të gjithë dëshmorëve tonë, e bëri realitet ëndrrën, mundin dhe gjakun e të gjithë heronjve, luftëtarëve, veprimtarëve dhe martirëve të lirisë, i bëri realitet aspiratat dhe dëshirat e shumë brezave të popullit tonë, e bëri realitet projektin e arkitektit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, presidentit tonë historik Ibrahim Rugova.Tashmë Republika e Kosovës është shtet i pavarur dhe sovran, i cili dita ditës po e sforcon subjektivitetin shtetëror, si në rrafshin nacional ashtu edhe në atë ndërkombëtar".Duke iu drejtuar të pranishmëve, ministri Demolli shtoi: "Të nderuar të pranishëm, Kompleksi Memorial që nga dita e sotme, po pasurohet edhe më shumë, sepse po kompletohet edhe me trupin e heroit ZahirPajaziti. Komplekset monumentale për heronjtë e kombit nuk janë vetëm vende përkujtimi, por ato shërbejnë për gjenerata të tëra edhe si burime të mësimit të historisë së lavdishme të kombit tonë, si dhe burim për frymëzimin e brezave të rinj me ndjenjën e patriotizmit dhe atdhedashurisë. I tillë do të jetë tash e mot edhe kompleksi memorial ZahirPajaziti, i cili i rritë lavdinë, jo vetën familjes, fshatit dhe rrethinës por edhe mbarë Kosovës dhe kombit shqiptar.Sakrifica dhe rënia heroike e Zahirit me shokë, dhe të gjithë heronjve të tjerë të kombit, për të gjithë ne paraqet një obligim, që të punojmë me nderë e përkushtim në krijimin dhe ndërtimin e shtetit tonë, i cili do të angazhohet dhe përkujdeset për ngritjen e mirëqenies së familjeve të dëshmorëve, veteranëve të luftës dhe të gjithë qytetarëve tonë.Shtet i cili në vazhdën e angazhimit për konsolidimin e organeve të veta më vitale shtetërore, do të ndërmerr të gjitha veprimet ligjore dhe kushtetuese për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës.Shtet i cili do të përmbush kriteret dhe standardet për tu anëtarësuar dhe integruar si në Unionin Evropian ashtu edhe në Aleancën Veri Atlantike të NATO-s, si dhe organizmat tjerë relevantë ndërkombëtar. Pikërisht ndërtimi i shtetit të tillë të Kosovës, si një shtet i lirë i pavarur dhe demokratik, do të paraqet plotësimin më të mirë të amanetit të Zahirit me shokë, si dhe të gjithë, heronjve, dëshmorëve dhe veprimtarëve që sakrifikuan dhe kontribuuan për liri.Qoftë i përjetshëm kujtimi për jetën dhe veprën e heronjve të kombit ZahirPajaziti, HakifZejnullahu dhe Edmond Hoxha" tha në fund, ministri Haki Demolli.




FSK-ja i dhuron një karrige stomatologjike Komunës së Artanës

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në kuadër të aktiviteteve të saj, rëndësi të posaçme i kushton realizimit të projekteve të ndryshme humanitare në dobi të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në organizim të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të MFSK-së, më 9 shkurt 2017, komunës së Artanës (NovoBërdës) iu dhurua një karrige stomatologjike, dedikuar fshatit Llabjanë të kësaj komune.Në ceremoni të pranishëm ishin; kryetari i Komunës së Artanës, zyrtarë të Drejtorisë së Shëndetësisë, stafi mjekësor i Ambulancës së fshatit Llabjan, zyrtarë të lartë të MFSK/FSK-së, si dhe atasheu i Mbrojtjes së SHBA-së, major Murillo.Ky donacioni nga Qendra Klinike Stomatologjike e Kosovës kishte për qëllim lehtësimin e nevojave të qytetarëve të Artanës, për t'iu mundësuar atyre kryejnë e disa shërbimeve stomatologjike në Ambulancën e fshatit. Në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës, nënkoloneli Afrim Veseli, karrigen ia dorëzoj kryetarit të Artanës, z. Ivanoviq, duke theksuar se MFSK-ja është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe komuniteteve pa dallim. Ai premtoi se edhe në të ardhmen FSK-ja do t'i ndihmojë qytetarët e vendit pa dallime përkatësie etnike, gjuhësore apo fetare.Ndërsa kryetari i Komunës së Artanës, z. Sevetisllav Ivanoviq, në emër të gjithë qytetarëve të komunës falënderoi FSK-në për ndihmën e ofruar duke thënë se: "Kërriga stomatologjike, për ne ka qenë prioritet, si pajisje mjaft e rëndësishme në shërbim të gjithë qytetarëve të kësaj ane, sidomos në shërbim të fëmijëve dhe nxënëseve", tha në fund z. Ivanoviq.

Nënkoloneli Avdullah Bajraktari pensionohet nga shërbimi në FSK

Në Batalionin e Xhenios të Brigadës për Mbështetje Operacionale-kazerma ,,Adem Jashari" në Prishtinë, më 9 shkurt 2017, u mbajt një ceremoni me rastin e pensionimit të oficerit të lartë, nënkolonel Avdulla Bajraktari.Në shenjë falënderimi për punën dhe kontributin e nënkolonel Bajraktarit gjatë shërbimit të tij në FSK, komandanti i FSK-së e shpërbleu atë me "Medaljen e Karrierës" (Gradën e Nderit), ndërsa Batalioni i Xhenios, dha mirënjohje me moton: "Ju faleminderit për shërbimin tuaj ndaj vendit". Komandanti i Batalionit të Xhenios, nënkolonel FidaimElshani, ndër të tjera tha: "Nënkolonel Bajraktari ka dhënë shembullin më të mirë se si



duhet punuar dhe vepruar për ta bërë shtetin tonë një vend të lirë, të sigurt dhe të zhvilluar. Pensionimi është një ngjarje me rëndësi në kalendarin e jetës tonë. Sot, kjo ngjarje e veçantë, paraqet kujdesin e institucionit ndaj pjesëtarëve të saj, duke shprehur nderin dhe respektin e ndërsjellë ndaj njëri-tjetrit, gjë që rrit moralin dhe motivin për të qenë krenarë që jemi pjesë e FSK-së".

Nënkolonel Avdulla Bajraktari ka një veprimtari të begatë të kontributit të tij për Kosovën, si në aspektin kombëtar, institucional, moral dhe njerëzor. Së pari si ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte angazhuar për t'i dalë zot atdheut, duke shfaqur edhe aftësi drejtuese, ku ndër të tjera ka udhëhequr grupe vullnetarësh për tu pajisur me armatim në Shqipëri.Me transformimin e UÇK-së në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, pa shkëputje angazhohet në Zonën e Parë Mbrojtëse. Nga tetori i vitit 2002, në Komandën e Logjistikës, është emëruar shef menaxhimit, deri në vitin 2009. Gjatë kësaj periudhe ka kryer shumë trajnime dhe detyra shtesë më rëndësi. Ka qenë pjesë e grupit punues për transformimin e TMK-së në FSK. Në FSK emërohet në shef i Sektorit të Logjistikës në Batalionin e Xhenios, duke kryer shpesh edhe detyra shtesë, ku gjithherë ka treguar profesionalizëm. Nënkoloneli Avdullah Bajraktari e ka dëshmuar humanizmin dhe solidaritetin e tij edhe gjatë aksioneve për dhurimin e gjakut, duke dhuruar gjak më shumë se dhjetëra herë.

Certifikohen 50 pjesëtarë të FSK-së në "Kursin për Lider Luftarak"



Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) çdo ditë e më tepër është duke i zhvilluar kapacitetet e saj të stërvitjes. Më 13 shkurt 2017, u certifikuan edhe 50 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës të cilët përfunduan me sukses"Kursin e Liderit Luftarak".Komandanti i KDS-së gjeneral brigade Enver Cikaqi në fjalën e tij, nder të tjera tha: Ne jemi të gatshëm të punojmë në drejtim të përmbushjes së misionit tonë. Pjesëtarët, të cilët morën pjesë në këtë kursi, me angazhimin e tyre e bënë kursin edhe më të rëndësishëm, ndërsa instruktorët amerikanë nga Bondsteeli, të cilët ndihmuan në realizimin e kursit, bënë që ky kurs të jetë i kompletuar në të gjitha aspektet si në planifikim, ekzekutim dhe vlerësim". Ai më tej theksoi se, 50 pjesëtarët që mbaruan këtë kurs do të lehtësojnë kryerjen e detyrave nëpër njësitë e tyre në FSK.Nënkolonel Adem Haxhosaj komandant i Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve foli për rolin dhe rëndësinë e kursit duke shtuar se, " ne e organizojmë këtë lloj kursi që nga viti 2012 dhe është një program mësimor i bazuar në modelin e sistemit të edukimit të nënoficerëve nga ushtria e SHBA-së, që ka për qëllim zhvillimin e njohurive dhe ngritjen e aftësive profesionale për udhëheqës ekipi dhe skuadre"."Kursi i Liderit Luftarak" është përqendruar në tri fusha kryesore të mësimit dhe në bllokun e ushtrimit fushor. Fushat kryesore të ligjërimit janë: Moduli i Lidershipit, Moduli i Trajnimeve dhe Moduli i Luftimeve.Ky kurs i cili ka zgjatur katër javë iu ka mundësuar pjesëmarrësve ngritjen e tyre profesionale dhe po ashtu do t'ju shërbejë edhe në ngritje e karrierës së tyre ushtarake.
Rreshter majori komandues i Bondsteel, Jeffrey Schuster tha se, gjatë kësaj periudhe kam parë një angazhim të lartë të pjesëtarëve të FSK-së dhe po ashtu një përkushtim të jashtëzakonshëm të instruktorëve për të dhënë më të mirën e tyre gjatë përgatitjes së pjesëtarëve të FSK-së. Ai më tej theksoi se, ne do të jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë edhe në stërvitjet e ardhshme, qoftë të llojit të njëjtë apo çfarëdolloj stërvitjesh tjera për të cilat FSK-ja ka nevojë për mbështetje. Pas përfundimit të ceremonisë së certifikimit të pjesëtarëve të FSK, rreshter majori i komandës i FSK-së Genc Metaj me rreshterët e parë të njësive të FSK dhe rreshter majorin komandues të Bondsteel-it Jeffrey A Schuster dhe nënoficerët e Bondstillit, zhvilluan një takim të përbashkët ku diskutuan për rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të nënoficerëve, si dhe koordinimin e aktiviteteve në mes FSK-së dhe Bondsteel-it edhe në të ardhmen.

FSK-ja mbajti ligjërata për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve shpërthyese



Instruktorët e Kompanisë së Deminimit të FSK-së, më 13 shkurt 2017, mbajtën ligjërata për vetëdijesimin e nxënësve nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera, në disa shkolla fillore të Komunës së Kastriotit ish-Obiliqi, si në shkollën "DositejObrdoviq"(me nxënës të komunitetit serb), dhe "Ibrahim Rugova".Këto ligjërata organizohen nga Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Zyra për Komunitete në kuadër të MFSK-së dhe realizohen nga Kompania e Deminimit e FSK-së, përkatësisht nga instruktorët e kësaj kompanie. Gjatë mbajtjes së ligjëratave në shkollat e Kastriotit, ishin të pranishëm edhe komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) kolonel ShaipHaziri, drejtori i NALT-it (Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s) gjeneral brigade Dietmar Mosmann, këshilltarë të NALT-it dhe mysafir të tjerë të NATO-s dhe KFOR-it.Nxënësit fillimisht i përshëndetën komandanti i RMC-së, kolonel ShaipHaziri dhe drejtori i NALT-t, gjenerali Dietmar Mosmann, të cilët u shprehën mjaft të kënaqur me interesimin që treguan nxënësit për t'u pajisur me sa më shumë njohuri rreth mjeteve të rrezikshme. Ata nder të tjera i porositen nxënësit që të tregohen të kujdesshme ndaj mjeteve të panjohura të cilat mund të paraqesin rrezik për jetën e tyre, si dhe i uruan ata që të rritën në paqe dhe liri, pa mina dhe mjete tjera të pashpërthyera. Të gjithë nxënësit që morën pjesë në këto ligjërata, qoftë nga komuniteti serb, qoftë nga ai shqiptar u shprehen mjaft të interesuar për të mësuar sa më shumë rreth këtyre mjeteve, gjë që tregojnë edhe pyetjet e tyre të shumta që ua parashtruan ligjëruesve. Këto ligjërata po realizohen në bazë të planit për vitin 2017, plan ky i hartuar dhe i koordinuar nga Departamenti i BCU-së në MFSK në bashkëpunim edhe me drejtoritë e arsimit në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Instruktorët e deminimit të FSK-së, aktivitetin e tyre për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve shpërthyese do ta vazhdojnë nëpër shkollat e Republikës së Kosovës deri më 9 mars, atëherë kur fillon sezoni veror.

Bashkëpunim i frytshëm i Mjekësisë së MFSK-së me homologët e KFOR-it gjerman në Prizren

Më 15 shkurt 2017, drejtori i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, dr. Xhevdet Tahiraj, priti në takim pune një delegacion të KFOR-it gjerman të udhëhequr nga koloneli Fisherkëshilltar i komandantit të KFOR-it dhe nënkoloneli Lubekomandant i Kompanisë Muar dhe Kompanisë Mjekësore në Spitalin e KFOR-it-gjerman në Prizren, të cilët shoqëroheshin edhe nga këshilltari i MFSK-së, nënkolonel M.Girsse.Gjatë takimit dypalësh u bisedua për vazhdimin e bashkëpunimit në mes të shërbimit mjekësor të FSK-së dhe Spitalit Gjerman në Prizren, si dhe për mundësinë e dërgimit të ekipeve mjekësore të FSK-së, një herë në muaj, në Spitalin Gjerman në Prizren.
Theksojmë se bashkëpunimi në mes të shërbimit mjekësor të MFS-së/FSK-së dhe sektorit të shëndetësisë të kontingjentit gjerman në kuadër të KFOR-it është mjaft i ngushtë, dhe se të dy palët u zotuan për thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.



Pjesëtarë të FSK-së kryejnë trajnimin ,,Roli dhe përgjegjësia e nënoficerëve"

Në mjediset e kazermës "Adem Jashari" në Prishtinë, më 24 shkurt 2017, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët përfunduan trajnimin njëjavor me temën: ,,Roli dhe përgjegjësia e nënoficerëve - niveli i mesëm". Trajnimi u realizuar nga instruktorë të Gardës Kombëtare të Ajovës (IOWA-s) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, falënderoi ekipin mobil të Gardës Kombëtare të Ajovës për realizimin me sukses të këtij trajnimi.Ai nder tjera u shpreh: "Është shumë e rëndësishme që ne t'i marrim eksperiencat e partnerëve tanë dhe t'i përshtatim me nevojat tona, sidomos eksperiencat e Gardës Kombëtare të Ajovës pasi që edhe koncepti ynë është ndërtuar sipas konceptit dhe doktrinës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Andaj qe të ndërveprojmë me partnerët tanë në çdo kohë është e domosdoshme ngritja e nivelit të gjuhës angleze, në mënyrë që të kemi komunikim më të lehtë.Më gëzon fakti se oficerët dhe nënoficerët tanë po veprojnë ngushtë me partnerët nga Ajova dhe se ky bashkëpunim do të ndikojë në ngritjen dhe avancimin e standardeve tona në të gjitha njësitë, duke i shpërndarë dhe inkorporuar njohuritë e fituara gjatë këtij trajnimi. Po ashtu projekte me partnerët tanë do të zhvillojmë edhe në të ardhmen, varësisht nga nevojat tona".Ndërsa, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli theksoi rolin dhe rendësin që ka niveli i mesëm i nënoficerëve ku puna kryesore në forcë bie mbi krahët e tyre.Në fund të ceremonisë, komandanti i FSK-së gjeneral Rama dhe zv komandanti i KFT-së gjeneral Hazrolli ndanë mirënjohje për instruktorët e Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët realizuan këtë trajnim për ngritjen dhe profesionalizimin e kanalit mbështetës të nënoficerëve në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës.Në këtë ceremoni certifikimi, përveç komandantit të FSK-së gjenerallejtënant RrahmanRama dhe zëvendëskomandantit të KFT-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ishin të pranishëm edhe komandanti i Batalionit të Xhenios nënkolonel FidaimElshani dhe disa oficerë të lartë të FSK-së.

Granit Kryeziu, ushtar i FSK-së zuri vendin e parë në "Dita e Vrapimit 2017"në Shqipëri

Më 17 shkurt 2017, 10 pjesëtarë të FSK-së morën pjesë në aktivitetin sportiv "Dita e Vrapimit CISM 2017", të organizuar nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, e cila përkoi me ditën e festimit të përvjetorit të 9-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Pjesëtarët e FSK-së, me ftesë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), morën pjesë në një aktivitet vjetor sportiv dhe kondicional të Forcave të Armatosura Shqiptare "Dita e Vrapimit CISM 2017". Ky aktivitet u zhvillua në ambientet e Forcave Tokësore në Zall Herr në dy disiplina; 5 kilometra për meshkuj dhe 3 kilometra për femra dhe u përcoll me interesim edhe nga drejtuesit e lartë të FARSH-it!

Në konkurrencën e meshkujve, ushtari i FSK-së Granit Kryeziu nga Brigada e Reagimit të Shpejtë, bindshëm fitoi vendin e parë, me çka edhe u shpërblye me kupë! Ndërsa, në konkurrencën e femrave, pra në shtegun prej 3 kilometrash, vendin e dytë e zuri tetar Mimoza Morina nga KDS-ja. Vlen të theksohet se të gjithë pjesëtarët e FSK-së, që morën pjesë e në këtë garë, treguan përgatitje dhe disiplinë të lartë, për çka morën edhe lëvdata nga drejtuesit e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Pjesëtarë të FSK-së licencohen për instruktorë të arteve marciale



Në datën 10.02,2017 në ambientet e kazermës "Adem Jashari" në Prishtinë u certifikuan 10 pjesëtarë në trajnimin fizik për instruktorë në lëmin e arteve marciale, i cili trajnim u realizua nga një ekip mobil i instruktorëve të Marinës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA).Të pranishëm në ceremoninë e certifikimit ishin edhe zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli si dhe oficerë të lartë të FSK-së.Me këtë rast gjeneral Hazrolli iu drejtua gjithë të pranishmëve me një fjalë rasti:" Ky trajnim është një vlerë e re, një aftësi e re dhe një mundësi e re. Në kontekst të kësaj dua t'ju siguroj që do t'i përdorim këto vlera dhe aftësi të reja, duke i futur si kurs në plan- programin e zhvillimit të nënoficerëve, dhe pa diskutim se kjo do të shërbejë si një mundësi e mirë për aftësimin e secilit pjesëtarë të FSK-së. "Më pas, gjeneral Hazrolli në emër të KOMFSK-së i uroi pjesëtarët që u certifikuan dhe njëherazi falënderoi Ambasadën amerikane për mbështetjen e dhënë në fushën e arteve marciale. Me këtë rast pesë nga pjesëtarët të cilët u certifikuan u licencuan për instruktorë të arteve marciale, të cilët në të ardhmen do të realizojnë trajnime për pjesëtarët e të gjitha njësive të FSK-së.

Qëllimi i këtij trajnimi është që krahas ngritjes profesionale në fushat tjera, pjesëtarët e FSK-së të jenë të përgatitur edhe fizikisht në përballimin e çdo lloj sfide, qoftë fizike apo psikike.

Ushtari Valon Halimi sportist i dalluar në sportet luftarake

Valoni ka fituar shumë tituj me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar në karate, si dhe të drejtën e ndarjes së drejtësisë-gjyqtar i nivelit ndërkombëtar.

Valon Halimi është ushtar i Forcës së Sigurisë të Kosovës i sistemuar në Brigadën e Reagimit të Shpejtë të Batalionit të Parë në Gjilan. Valoni ka lindur, 28 vjet më parë, në fshatin Orllan të komunës së Podujevës. Valoni qysh në moshë të re filloi të merret me sportin e karatesë, edhe pse në kushte jo të mira financiare, me punë vetëmohuese dhe të pandërprerë, arriti që me sukses, ta realizojë ëndrrën e tij djaloshare, dhe të bëhet sot, një sportist i dalluar jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj.Ushtrimet e para i filloi gjatë vitit 2000, në klubin e karatesë (drejtimi-shotokan) "Kosovari" në Prishtinë, ku me punën dhe angazhimin e tij, arriti që në vitin 2003-2004, të marrë pjesë në shumë gara me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, që rezultuan të jenë mjaft të suksesshme për karrierën e tij.Në tetor të vitit 2003, në Kampionatin e Kosovës mori çmimin e parë duke u bërë kampion i Kosovës në Kumite (lufta), po gjatë këtij viti, në muajin nëntor në Tiranë, u shpërblye me medalje të artë në kumitë-luftëra, dhe nën kampion në Kata, në prill 2004, në Turneun Ndërkombëtar në Shkup, zuri vendin e parë në Kumite dhe vendin e dytë në Kata. Në maj të vitit 2004, në Mal të zi, vendin e parë në turneun Ndërkombëtar në Kata, në nëntor të vitit 2004, vendin e dytë në Kata dhe vendin e tretë në Kumite dhe shumë medalje në gara kombëtare. Duke mos mjaftuar gjithë këto çmime që mori në qershor të vitit 2004, arriti deri te shkalla 1 DAN (mjeshtër i karatesë), që ndryshe quhet Shiritit i Zi, gjithashtu gjatë këtij viti mjeshtri i karatesë ShihanMarlonMoore gjatë vizitës që i bëri Kosovës, Valonin e angazhoi trajner në Klubin e Karatesë "Fudochi" Orllan. Prej vitit 2005, ka organizuar turneun në emër të heroit të kombit "ZahirPajaziti në Orllan dhe njëherë është aktiv në gara kombëtare dhe ndërkombëtare, me q'rast është treguar edhe mjaft i suksesshëm edhe më nxënësit e tij, të klubit të cilët kanë arritur suksese të mëdha duke fituar afër 1500 medalje të ndryshme, të shpallen kampion, nën kampion dhe disa të certifikuar me Breza të Zi.Viti 2008, për Valonin ishte gjithashtu mjaft i suksesshëm, me dt. 08 qershor të këtij viti, u certifikua me shkallën 2 DAN para komisionit të Federatës së Karatesë së Kosovës (FKK) ku ndjekë edhe disa seminare të ndryshme ku gjatë vitit 2007 u certifikua gjyqtar i Kosovës, ndërsa pas angazhimeve të tij të vazhdueshme seminareve dhe trajnimeve të ndryshme në mars të vitit 2011, u ngrit në gjyqtar kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjatë vitit 2014, ka arritur që të certifikohet në granden 3 DAN para mjeshtërve të karatesë amerikanë; MarlonMoore 8 DAN, RayHughes 6 DAN, DavglasJeppersoon 5 DAN.Puna në FSK dhe aktivitetet sportive të Valonit, janë të lidhur ngushtë ndërmjet veti, gjë që i ka ndihmuar Valonit që të ece më tutje në karrierë dhe aktivitetet në FSK kanë ndikuar që të jetë i përgatitur fizikisht gjatë tërë kohës.Tani më Valoni është dukë studiuar në Kolegjin Universum drejtimi Edukatë Fizike dhe është trajner i klubit të karatesë "Fudochi" dhe shpreson që gjatë të ardhmes të hapi klub të karatesë në Prishtinë, dhe të vazhdojë me ngritje profesionale në referim.





FORCA JONË

* * * Viti VI • Nr. 56 • Prill 2017 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri Haki Demolli priti zëvendës ndihmësin e sekretarit amerikan të shtetit për çështje evropiane dhe euroaziatike, Hoyt Brian Yee

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, më 29.03.2017, priti në takim zëvendës ndihmësin e sekretarit amerikan të shtetit për çështje evropiane dhe euro aziatike, z. Hoyt Brian Yee. Në takim merrnin pjesë edhe zëvendësministri Muhamet Latifi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kurse zotin Yee, e shoqëronin atasheu ushtarak i SHBA-ve, në Prishtinë, kolonel Jeffrey H. Fisher dhe këshilltari ushtarak Joshua Rubin. Me këtë rast, Ministri Haki Demolli, në emër të Ministrisë dhe FSK-së e falënderoi zëvendës ndihmësin e sekretarit amerikan të shtetit për çështje evropiane dhe euro aziatike, z. Hoyt Yee, për ndihmën që SHBA-të po japin për FSK-në, vlerësoi lartë bashkëpunimin e dy shteteve dhe në veçanti Partneritetin e Bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ministri Demolli e njoftoi z. Yee edhe me bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtar, pjesëmarrjen e FSK-së në shumë trajnime me karakter rajonal, si dhe sukseset e arritura në garat ndërkombëtare. Gjithashtu ministri Haki Demolli, zotin Yee e njoftoi edhe për bashkëpunimin me DIRI-in në procesin e planifikimit të transformimit të FSK-së, si edhe me ecurinë e zhvillimit të procedurave për projektligjin për zgjerimin e misionit të FSK-së. Nga ana e tij, zëvendës ndihmësi i Sekretarit Amerikan të shtetit për Çështje evropiane dhe euro aziatike, z. Hoyt Yee, falënderoi ministrin Demolli për pritjen dhe përcolli mesazhin se Uashingtoni zyrtar është i shqetësuar rreth procesit të transformimit të FSK-së me ligj.




Në MFSK u mbajt trajnimi "Ndërtimi i Integritetit për Liderët e Lartë"

Pjesëtarë të lartë të Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së, nga data 27-30 mars 2017, për katër ditë rresht ndoqën trajnimin me temë: "Ndërtimi i Integritetit për Liderët e Lartë", të mbajtur nga instruktorë të Akademisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar. Në ditën e parë të trajnimit, ministri i MFSK-së, Haki Demolli, falënderoi Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e tyre të vazhdueshme dhe për bashkëpunimin e ngushtë me MFSK-në dhe FSK-në. Ndërkaq, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, z. Ruairi O'Connell falënderoi ministrin Demolli për vlerësimin dhe premtoi ndihmë për FSK-në edhe në të ardhmen, duke theksuar se FSK-ja është institucioni më i besuar për qytetarët e Kosovës Në përmbyllje të këtij trajnimi, sot nën organizimin e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, në hotelin SIRIUS, u mbajt ceremonia e certifikimit për pjesëmarrësit e këtij trajnimi. Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë fjalës së tij të mbajtur me këtë rast, veç tjerash vlerësoi lart ndihmën e pakursyer të Akademisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar që po jep për shkollimin dhe trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së. Gjeneral Rama tha se këto trajnime janë me interes të veçantë për FSK-në, sepse janë të lidhura drejtpërdrejtë me ngritjen e integritetit të saj. Ai, ndër tjera u shpreh se: "Kurs i Zhvillimit të Integritetit për udhëheqës të lartë fokusohet tek kolonelët/nënkolonelët dhe më lart, në grada ekuivalente ushtarake dhe civile, nga sektori i gjerë i mbrojtjes dhe sigurisë, për të shqyrtuar aspektet kryesore të adresimit të rrezikut të korrupsionit në kuadër të sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë, në fushat e financave, blerjeve dhe prokurimit, menaxhimit të resurseve njerëzore dhe tek operativa. Ne aspirojmë të jemi pjesë e NATO-s. NATO-ja tashmë ka një Politikë të Zhvillimit të Integritetit, e cila është nënshkruar nga 28 shtetet në Samitin e Varshavës, në korrik të vitit 2016, dhe është edhe një nder kriteret kryesore për të qenë pjesë e saj", - tha gjeneral Rama.



FSK-institucioni më i besueshëm në Republikën e Kosovës




"Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave KIPRED", më 24 mars 2017, para mediave bëri shpalosjen e matjeve të opinionit publik kosovar të periudhës 15 nëntor 2016 deri me 15 shkurt 2017, për institucionet e sigurisë në vend dhe për drejtuesit kryesor të këtyre institucioneve. Sipas rezultateve të prezantuara edhe këtë radhë, për herë të pestë (5), FSK rezulton se është vlerësuar si institucioni më i besueshëm i sigurisë në Kosovë, me shkallën më të lartë 3.74. Kurse në vlerësimin e drejtuesve të institucioneve të sigurisë, ministri i MFSK-së zoti Haki Demolli është vlerësuar me shkallën më të lartë 2.88. Sipas publikimit, Forca e Sigurisë së Kosovës besueshmërinë më të lartë, sipas rajoneve e ka nga qytetarët shqiptarë të veriut të vendit, përderisa ka ndryshime të shifrave në përqindje në rajonet tjera, që gjithashtu besueshmëria për FSK-në është e lartë. Këto vlerësime janë pasqyrim i rezultateve të punës së palodhshme dhe të përkushtuar të të gjithë pjesëtarëve të FSK-së. Ky rezultat është edhe pasojë e menaxhimit dhe drejtimit shumë transparente të MFSK-së dhe FSK, në kryerjen e detyrave që dalin nga misioni aktual që kanë. Sigurisht se këto vlerësime të larta edhe më shumë e obligojnë FSK-në dhe MFSK-në, që edhe në të ardhmen të angazhohen edhe më shumë në realizimin e objektivave të planifikuar dhe kryerjen e detyrave të përgjithshme, që dalin nga Plani i Veprimit Vjetor të Punës.

Në takim, nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, morën pjesë, gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Departamentit të Operacioneve dhe Ibrahim Shala, drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, si dhe deputet e përfaqësues të institucioneve tjera të sigurisë.

Ministri Haki Demolli e takoi ambasadorin e Kanadasë në Kosovë

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, z. Haki Demolli, priti sot ambasadorin jo-rezident të Kanadasë në Republikën e Kosovës, z. Daniel Maksymiuk, të cilin z. Demolli e falënderoi për përkrahjen që Kanadaja dhe Ministria e saj e Mbrojtjes po japin për MSK-në. Ministri Demolli dhe ambasadori Maksymiuk biseduan edhe për marrëdhëniet e mira ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Kanadasë, me theks të veçantë për bashkëpunimin e mirë ndërmjet dy ministrive të Mbrojtjes. Ministri Demolli, me këtë rast, e njoftoi ambasadorin me zhvillimet e përgjithshme në FSK dhe me zhvillimet rreth projektligjit për FSK-në. Gjithashtu ministri Demolli dhe ambasadori Maksymiuk biseduan edhe për mundësitë e bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Kanadasë, por edhe në fusha tjera përkatëse në nivel vendi. Nga ana e tij, ambasadori Daniel Maksymiuk premtoi se do të angazhohet për thellimin e bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Kanadasë edhe në fusha tjera, dhe në këtë kontekst edhe në mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Kanadasë.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli vizitoi Qendrën për Studime Universitare të FSK-së



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, më 8 mars 2017, vizitoi Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, në kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, për një vizitë urimi dhe bashkëbisedimi me kadetët dhe oficerët e FSK-së. Zotit Veselit, mirëseardhje i dëshiruan komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendës komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe komandanti i QSU-së, major Avni Kiqina. Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli, në njërën nga sallat e Qendrës për Studime Universitare, takoi kadetët e FSK-së, ku u shpreh se ndihet i privilegjuar, "që sot jam para jush, për t'ju informuar për hapat të cilët po mirën për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës". FSK-ja, që nga viti 2013 i ka arritur kapacitet e saj, për ta ndryshuar misionin. Duke ju drejtuar kadetëve tha: " Ju keni krijuar mundësinë që Kosova të jetë para një vendimi historik. Siç e dini, presidenti i Kosovës, dje ka marrë një vendim i cili është në interesin e vendit tonë, me qëllim tërësisht paqësor, në mbështetje të qytetarëve të vendit dhe në fqinjësi të mirë me të gjithë fqinjët, por edhe me qëllimin e shenjtë, mbrojtjen e vendit tonë. Ushtria e Kosovës do të ketë për mision, Paqen në vend dhe rajon, do të jemi kontribuues të paqes me partnerët tanë, ku do që kërkohet, dhe njëherë jemi populli më liridashës, dhe nuk kemi as një pretendim përveç atij të paqes në rajon dhe në botë" theksoi në fund, z. Veseli.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti ambasadorin e Sllovakisë Lubomir Batary

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 22.03.2017, priti në takim shefin e zyrës ndërlidhëse të Republikës së Sllovakisë në Republikën e Kosovës, ambasadorin Lubomir Batary. Gjatë takimit që gjeneral Rama zhvilloi me ambasadorin Batery u shpreh se, FSK-ja ashtu siç është e përkushtuar për ruajtjen e vlerave të vendit tonë, po ashtu me të njëjtën gatishmëri dhe përkushtim përkujdeset edhe për ruajtjen e vlerave të popujve, të cilët kanë kontribuar për lirinë dhe paqen e vendit tonë. Ai tha se, FSK-ja me kënaqësi ka ndërmarrë iniciativën për riparimin e memorialit kushtuar ushtarëve të Forcave të Armatosura të Sllovakisë, të cilët patën humbur jetën në një fatkeqësi ajrore pas përfundimit të misionit në vendin tonë. Nga ana e tij, ambasadori i Republikës së Sllovakisë, Lubomir Batery, në emrin e tij personal dhe në emër të Forcave të Armatosura të Sllovakisë dhe në emër të popullit sllovak falënderoi komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën, për angazhimin dhe kujdesin e treguar në përkujtim të jetës dhe veprës së ushtarëve sllovakë. Vlen të shtojmë se, FSK-ja ka riparuar memorialin i cili u kushtohet 42 ushtarëve sllovakë të cilët kanë humbur jetën para 11 vitesh në një fatkeqësi ajrore, gjatë kthimit të tyre në atdhe, pas përfundimit të misionit në kuadër të KFOR-it.



Komandantja e KDS-së së FA të Shqipërisë gjeneral brigade Manushaqe Shehu vizitoi MFSK-në dhe FSK-në

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në takime të ndara pritën një delegacion të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në krye me gjeneral brigade Manushaqe Shehu, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Në fillim të takimit, ministri Haki Demolli u shpreh se bashkëpunimi i mirë bilateral dhe vëllazëror midis Ministrisë për FSK-në dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë është duke u kultivuar dhe zhvilluar çdo ditë e më shumë dhe me rezultate konkrete në gjitha fushat, dhe se ky bashkëpunim sidomos është me



rëndësi të veçantë sepse ka të bëjë me shkollimet, trajnimet dhe ngritjen profesionale të pjesëtarëve dhe njësive të FSK-së. Nga ana e saj, gjeneralja e parë shqiptare, zonja Manushaqe Shehu u shpreh se ndjehet e lumtur që në vizitën e saj të parë si gjeneral në FSK sheh zhvillim dhe avancim të shkëlqyeshëm. Gjeneral Shehu tha gjithashtu se vizita në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe më parë ajo në kazermën „Skënderbeu", ia kanë forcuar bindjen se FSK-ja është në rrugë të mbarë dhe të drejtë në arritjen e synimeve dhe qëllimeve të saj, për të qenë Forcë e Armatosur e Kosovës. Gjithashtu, në takimin e përbashkët që zhvilluan komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe gjeneral brigade Manushaqe Shehu, biseduan për bashkëpunimin e deritanishëm në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në veçanti rreth bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve në fushën e arsimimit, trajnimit dhe shkëmbimeve profesionale ndërmjet dy forcave.
Delegacioni i FA të Shqipërisë realizoi një vizitë pune edhe në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, ku u pritën nga komandanti i saj, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili e njoftoi delegacionin nga Shqipëria me misionin, detyrat dhe përgjegjësitë aktuale që ka KDS-ja, me synimet e saj në të ardhmen si dhe me përgatitjet rreth fazës së transformimit. Gjatë takimit u bisedua edhe për bashkëpunimin në shumë fusha si dhe shkëmbimin e përvojave. Gjeneral brigade, Manushaqe Shehu premtoi mbështetje për KDS-në në të gjitha fushat në të cilat ka nevojë, si duke ofruar trajnime, kuadro të specializuara apo literaturë të nevojshme. Më pas shefi i shtabit të KDS-së, nënkolonel Fadil Hoxha, bëri një prezantim të shkurtër për të pranishmit lidhur me aktivitetet e KDS-së. Të dy delegacionet vizituan edhe qendrat stërvitore, për t'u njohur nga afër me trajnimet dhe kurset që zhvillohen në këto qendra.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

FSK-ja shënoi 19 vjetorin e Epopesë së UÇK-së



Në Kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës, më 5 mars 2017, u mbajt manifestimi qendror në shënimin e 19 vjetorit të Epopesë së UÇK-së, në nderim të Komandanti Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit. Ky manifestim u mbajt nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa. Në manifestim ishin të pranishëm: Kryetari i Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës zotëri Kadri Veseli, kryeministri i Kosovës zotëri Isa Mustafa, ministri i MFSK-së zotëri Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadorë, ministra, deputet, veteranë, invalidë dhe përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, drejtues të institucioneve shtetërore të Kosovës, qytetarë dhe nxënës të shkollave të Kosovës. Pas revistës që iu bë kuadrateve të FSK-së, nga kryetari Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pas intonimit të himnit shtetërorë dhe kombëtar, drejtuesit e shtetit dhe përfaqësuesi i veteranëve të UÇK-së, vendosën kurora me lule pranë Obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri. Në manifestimin "Epopeja e UÇK-së", kryetari Hashim Thaçi, në fjalën e tij, pos tjerash tha: "Kushtetuta moderne e Kosovës, mua si Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë së Kosovës më jep kompetenca të mjaftueshme për të ndërmarr iniciativa për të ndryshuar ligjin për FSK-në". Ai duke iu drejtuar të pranishmëve, shtoi: "Para nesh të nderuar qytetarë janë rreshtuar pjesëtarët e FSK-së e që për mua si Komandant Suprem, dhe mbi të gjitha për ju qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, këta janë ushtarët dhe oficerët e Ushtrisë së Republikës së Kosovës. Asnjë qëndrim i caktuar i qarqeve jo dashamirëse nuk mund ta njollosë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Ajo mbetet trashëgimia jonë më e madhe dhe më e pasur që ka krijuar historia e Kosovës. Ashtu siç do të jetë e përjetshme dhe e vlerësuar lart sakrifica sublime e Jasharëve dhe gjithë dëshmorëve të Kosovës, ashtu do të jetë i përjetshëm lavdia dhe emri i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj të nderuar ushtarë të FSK-së, unë sot dua të bëj të qartë publikisht se në ditët në vijim shumë shpejt, brenda kompetencave të mia kushtetuese, do të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme ligjore që transformimi i shumë pritur i themelimit të Ushtrisë së Kosovës të bëhet edhe nëpërmjet ndryshimit të ligjit për FSK-në", e përmbylli fjalën e tij, kryetari i Kosovës Hashim Thaçi. Ndërsa kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa në fjalën e tij, ndër të tjera theksoi: "Epopeja e UÇK-së" për çdo qytetar të Kosovës është festë e lirisë së Kosovës, është kremtja e vlerave të atdhedashurisë, patriotizmit dhe sakrificës sublime për Kosovën. Kosova, institucionet e saj, si dhe qytetarët kanë sfidat e veta, që janë të shumta dhe të cilat ndryshojnë krahas prosperitetit tonë. Kosova ka bërë transformime epokale dhe historike, falë rezistencës së saj paqësore, unike për këtë pjesë të botës, falë luftës çlirimtare të popullit të saj. Ne sot mburremi me institucionet e reja shtetërore të ngritura në partneritet me miqtë tanë, mburremi me Forcën e Sigurisë së Kosovës, në të cilën shohim ushtrinë tonë, një forcë paqeje e stabiliteti jo vetëm në rajon por edhe më gjerë, një anëtare të ardhshme të Aleancës Veri atlantike. Kemi policinë, institucionet e sigurisë të afta dhe të organizuara sipas standardeve më të larta". Në përfundim të manifestimit Trupa Muzikore e FSK-së ekzekutoi disa pika muzikore.





Ministri dhe Komandanti i FSK-së, bënë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz

Në përvjetorin e 19 të Epopesë së UÇK-së dhe në nderim të Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit, një delegacion i Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së, të prirë nga ministri Haki Demolli, e ku merrnin pjesë edhe zëvendësministri Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, stafi i lartë i Ministrisë dhe oficerë të lartë të FSK-së, në shenjë nderimi vendosën kurora me lule dhe bënë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Gjithashtu Ministri i FSK-së, zoti Haki Demolli së bashku me delegacionin e FSK-së, vizituan edhe familjen Jashari, ku u pritë nga zoti Murat Jashari. Ministri Demolli me këtë rast, në emër të delegacionit të MFSK-së, çmoj lartë sakrificën e pashembullt të Komandantit Legjendar Adem Jashari, të familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit. "Sot, unë si ministër i FSK-së, së bashku me zëvendës ministrin, komandantin e FSK-së, dhe eprorë më të lartë të FSK-së, dolëm për të bërë homazhe në shenjë nderimi, në shenjë respekti dhe përkushtimit të veprës heroike të Komandantit Legjendar, për sakrificën e familjes Jashari dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të tij. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se gjaku i tyre ka ngritur themelet e lirisë dhe gjaku i tyre është gjaku i lirisë; andaj të gjithë qytetarët përfshirë edhe institucionet kanë për obligim që të respektojnë me përkushtim veprën e tyre" tha ministri i MFSK-së, Haki Demolli.



FSK-ja me sukses zhvilloi ushtrim

Gjenerali Gëzim Hazrolli vlerësoi lart procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor „Veprimi i Shpejtë 10", si dhe koordinimin ndërmjet agjencive civile dhe Batalionit të Tretë-të BRSH-së.



Në kuadër të gjenerimit të Forcës për fazën e parë të vitit 2017, Batalioni i Tretë i Brigadës për Reagim të Shpejtë ka realizuar me sukses ushtrimin fushor të koduar "Veprimi i Shpejtë 10" në bashkëveprim me Kuvendin Komunal të Obiliqit, i cili proces ishte në vazhdimësi. Kompania 3C e Batalionit të Tretë ka realizuar trajnimin në një cikël tremujor, i cili ka filluar nga data 10 janar 2017 dhe ka përfunduar më 16 mars 2017, duke u përmbyllur me ushtrimin fushor "VEPRIMI I SHPEJTË 10".

Trajnimi është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Tretë dhe është realizuar në nivel kompanie, si dhe është mbështetur dhe vlerësuar nga Komanda e Batalionit të Tretë, ekipet vlerësuese të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe ekipet këshilluese të NATO-s "NALT"

Synimi kryesor i Batalionit të Tretë është që përmes këtyre ushtrimeve fushore të arrijë një bashkëveprim me komunat në zonën e përgjegjësisë së Batalionit.

Në ushtrimet e radhës planifikohet që të vazhdohet me ushtrime fushore të ngjashme me komunat tjera në zonën e përgjegjësisë së Batalionit.

Ushtrimit fushor "Veprimi i Shpejtë 10" i realizuar në bashkëveprim me KFOR-in, Komunën e Obiliqit dhe agjencitë civile, kishte për qëllim aftësimin e njësive të FSK-së për reagim në situata të jashtëzakonshme dhe të sigurisë, si dhe aftësimin e tyre për detyra individuale dhe kolektive, duke filluar që nga faza e planifikimit, faza e ekzekutimit dhe e rikuperimit.

Procesi i ushtrimit fushor ka kaluar në një fazë të detajuar të planifikimit, në veçanti vlen të ceken konferencat planifikuese ndërmjet Batalionit të Tretë, Kuvendit Komunal të Obiliqit, agjencive emergjente në nivel komune, Policisë së Kosovës, Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Brigadës Zjarrfikëse Industriale të KEK-ut dhe ekipit këshillues të NATO-s.

Gjithsej kemi realizuar tri konferenca: Konferenca fillestare është mbajtur më datë 26.01.2017, konferenca kryesore më 14.02.2017, si dhe konferenca finale më 01.03.2017, përfshirë këtu edhe Brifingun për KK Obiliq. Qëllim kryesor i këtyre konferencave ishte sinkronizimi i veprimeve dhe ndërtimi i skenarëve për ushtrimin fushor.

Në konferencën e dytë kemi formuar grupet punuese për operacione dhe skenarë, ku në fakt i është dhënë forma dhe janë nxjerrë objektivat e të gjithë aktorëve pjesëmarrës në ushtrim.

Batalioni i Tretë në vazhdimësi ka koordinuar veprimet me institucionet dhe të gjithë aktorët pjesëmarrës në ushtrim fushor të koduar "Veprimi i Shpejtë 10".

Ushtrimi fushor ka filluar me ngritjen e gjendjes së gatishmërisë nga Komuna e Obiliqit, më 14.03.2017, fillimisht është caktuar komandanti i vend-incidentit, kryetari i komunës Xhafer Gashi. Komandanti i vend- incidentit z. Gashi ka marrë vendim për ngritjen e Qendrës Operative Lokale brenda hapësirës së termocentralit " Kosova A", ku më pas janë zhvendosur të gjithë drejtorët e drejtorive komunale dhe ka vazhduar me udhëheqjen e operacionit nga vend-incidenti. Operacionet kryesore nga Komuna e Obiliqit janë zhvilluar deri në ora 16:00L, ku Kuvendi Komunal është ballafaquar me skenarë të ndryshëm si: zjarrfikje, aksidente komunikacioni, menaxhim i turmave, ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe evakuimi i viktimave. Pas vazhdimit të gjendjes së rënduar në Komunën e Obiliqit dhe pamundësisë të vazhdimit të udhëheqjes së operacioneve për shkak të mungesës së resurseve dhe eskalimit të mëtutjeshëm të situatës, komandanti i vend- incidentit i ka dorëzuar Komandën e vend- incidentit- Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë, gjegjësisht komandantit të Kompanisë 3C, kapiten Alban Bunjakut, i cili më pas ka udhëhequr me operacionet në vend- incident.

Ushtrimi fushor ka zgjatur tri ditë, duke filluar nga data 14.03.2016 dhe duke përfun-





in fushor ‘VEPRIMI I SHPEJTË 10’



duar më datë 16.03.2016.

Për të përcjellë nga afër ushtrimin të pranishëm ishin: Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, kryetari i Kuvendit Komunal të Obiliqit, njëkohësisht edhe udhëheqës i operacioni në KEK, Xhafer Gashi, komandanti i Departamentit të Përbashkët-Veri, kolonel Martin Schuler (JRD-N), ushtruesi i detyrës së Komandantit të Brigadës së Reagimit të Shpejt, kolonel Xhevahir Geci, shefi i Shtabit të Brigadës për Reagim të Shpejtë nënkolonel Ejup Maqedonci, komandanti i Batalionit të Tretë nënkolonel Sylejman Cakaj, komandanti i Policisë Rajonale të Obiliqit toger Sejdi Zeqiri, etj.

Të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua gjenerali Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i KFT-së, i cili vlerësoi lart procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor ,,Veprimi i Shpejtë 10", si dhe koordinimin ndërmjet agjencive civile dhe Batalionit të Tretë-të BRSH-së. Ai ndër të tjera tha: "I falënderoj të gjithë të pranishmit të cilët kanë marrë pjesë në këtë ushtrim, kjo është një mundësi e jashtëzakonshme dhe një rast i veçantë që të fillojmë t'i identifikojmë kapacitetet tona si dhe të identifikojmë zbrazëtirat tonë për zhvillimin e operacioneve të tilla në menaxhimin e fatkeqësive të ndryshme. Si FSK, në kuadër të misionit që kemi, jemi gjithmonë të gatshëm që të zhvillojmë operacione të tilla sepse në këtë mënyrë zhvillojmë edhe kapacitetet tona. Po ashtu misioni i këtyre ushtrimeve është që të zhvillojmë edhe ndërveprojmë me institucionet tjera të sigurisë në vend.

Prandaj skenarë të tillë organizohen me qëllim që nesër të jemi të gatshëm të ndërveprojmë në raste të jashtëzakonshme si gjatë tërmeteve, vërshimeve dhe situatave tjera, me qëllim që të përgatitemi dhe të stërvitemi në kohë paqeje për menaxhimin e incidenteve, në mënyrë që nesër të jemi të gatshëm që secili të kryejë punën e tij, bazuar në Planin e Reagimit Kombëtar. Dua të falënderoj për mbështetje edhe kryetarin e Komunës së Obiliqit, z Gashi, i cili duke qenë sot i pranishëm pati mundësi t'i shohë kapacitetet që ka brenda komunës që ai drejton. Ky ushtrim nuk do të ishte i kompletuar pa pjesëmarrjen tuaj".

Një falënderim të veçantë, gjeneral Hazrolli i shprehu KFOR-it nga Ushtria Amerikane për kohën dhe mbështetjen me helikopter në këtë ushtrim, si dhe në emër të komandantit të FSK-së gjeneral Ramës i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e këtij ushtrimi.

Të pranishmëve iu drejtua dhe kryetari i Kuvendit Komunal Xhafer Gashi i cili i falënderoi pjesëmarrësit e në veçanti falënderoi FSK-në dhe KFOR-in për bashkëpunimin, duke thënë: "Me të vërtetë po ndihem shumë i emocionuar me veprimet e FSK-së, të cilat u realizuan në koordinim me të gjitha organet kompetente për kërkim-shpëtim. Është kënaqësi e veçantë që sot këtu e kemi edhe gjeneralin i cili për së afërmi e vëzhgoi këtë ushtrim të përbashkët. Në fund, Ai falënderoi të gjithë për realizimin me sukses të ushtrimit fushor të koduar "Veprimi i Shpejtë 10". Gjatë këtij ushtrimi, pjesëtarët e Kompanisë 3C dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht për operacione ushtarake si: patrullimet, pritat, kërkim dhe kordon, rikonicion të terrenit, sulm në nivel togu, marrje e objektivave, dhënie ndihmës së parë të lënduarve, trajtimin e tyre si dhe transportimin nga vend- incidenti. Vlen të theksohet se forcat nga KFOR-i amerikan na kanë ofruar mbështetje me helikopter për evakuimin e të lënduarve (MEDEVAC). Pjesëtarët treguan vendosmëri dhe moral të lartë për realizimin e misionit".

Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë edhe njësitë të specializuara të FSK-së nga Brigada për Mbështetje Operacionale (MKAB dhe KSH). Gjithashtu edhe Kompania 3A dhe Kompania 3B e Batalionit të Tretë kanë qenë të angazhuar në ushtrimin në vendkomandë (UVK).

Në ditën përfundimtare të këtij ushtrimi u ekzekutuan gjithsej shtatë operacione të ndryshme si: Menaxhimi i turmave, Zjarr në lokacione urbane, Aksident komunikacioni, Trajtim mjekësor, Kërkim-shpëtim me litar, Zonë e kontaminuar, Operacione urbane, si dhe me mbështetjen e KFOR-it në tërheqjen e të lënduarve me helikopter. Për më tepër ky ushtrim dëshmoi që Batalioni i Tretë është i përgatitur dhe ka kapacitete të ekzekutojë operacione, si njësi e pavarur në terren, për të realizuar qëllimin e komandantit.





Komandanti i Akademisë së nënoficerëve të armatës së 7-të Ushtrisë Amerikane vizitoi KDS-në

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Gjeneral brigade Enver Cikaqi, priti në një takim delegacionin e Akademisë së nënoficerëve të armatës së 7-të të ushtrisë amerikane, të kryesuar nga rreshter majori Gregory Smith-komandant i Akademisë së nënoficerëve. Me këtë rast, gjeneral Cikaqi falënderoi delegacionin e akademisë së nënoficerëve për mbështetjen që po i japin nënoficerëve të KDS-së, e posaçërisht instruktorëve të saj për realizimin e trajnimeve të fushave të ndryshme. Takimin me delegacionin e Akademisë së nënoficerëve nga SHBA-të, me të gjithë rreshter majorët komandues të njësive të FSK-së e hapi rreshteri i parë i KDS-së Xhevdet Mataj. Në këtë takim Rreshter majori i Komandës së FSK-së Genc Metaj i njoftoi mysafirët me të arriturat e nënoficerëve të FSK-së, si dhe foli për planifikimin dhe trajnimet që do të realizohen në të ardhmen. Po ashtu ai falënderoi delegacionin nga ushtria e SHBA-ve për mbështetjen e vazhdueshme që po jep, duke filluar nga certifikimi i instruktorëve për kurset e ndryshme profesionale dhe mbështetjen në fushën e mentorimit dhe këshillimit, si dhe për mbështetje me trajnerë në trajnime nga Akademia e nënoficerëve, të adoptuara për nevojat dhe kushtet e FSK-së. Komandanti i Akademisë së nënoficerëve rreshter majori Gregory Smith i shoqëruar nga nënoficerë tjerë pas takimit u shpreh se; vërtetë ndjehet i lum-



tur që po sheh këto të arritura të pjesëtarët e FSK-së, sidomos te instruktorët, që për një kohë të shkurtër kanë arritur të zhvillojnë kurset e tyre dhe të avancojnë në nivel kaq të lartë. Delegacioni i Akademisë së nënoficerëve nga ushtria e SHBA-ve, të shoqëruar nga nënoficerët e FSK-së, vizituan disa nga trajnimet të cilat po zhvillohen në KDS, për ti parë nga afër kualitetet që ofrojnë instruktorët dhe shkollat në KDS. Bashkërisht nënoficerët e FSK-së dhe ata të Akademisë së 7-të u dakorduan, që të vazhdojë kjo formë e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, me qëllim që të avancohen kapacitetet trajnuese, por edhe të certifikohen instruktorë për fushat që FSK ka nevojë. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes organizon stërvitje individuale dhe kolektive për nënoficerët e KDS, ndërsa Akademia e nënoficerëve dhe kampi Bondstill me instruktorë e tyre, kanë ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme ngritjen dhe zhvillimin e nënoficerëve të FSK-së.

Certifikohen 24 pjesëtarë të FSK-së në trajnimin mjekësor "Personi i parë në vendngjarje"

Në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, më 3.03.2017, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët për dy javë kryen trajnimin mjekësor," Personi i parë në vendngjarje" të mbajtur nga instruktorët Britanisë së Madhe. "Është shumë me rëndësi kur jeni në mision apo betejë, dhe kur e dini se nëse ndodh të plagoseni rëndë është dikush pran jush, që mund të ju mbaj gjallë, deri sa të vjen ndihma profesionale mjekësore dhe kjo e rrit moralin e luftës" tha në fillim të fjalës së tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, për të shtuar se: "Prej një ushtari kërkohet jo më shumë se të jetë fizikisht i përgatitur, të dinë të përdor armët dhe të jetë në gjendje ta ndihmojë shokun në raste lëndimi". Komandanti i FSK-së, duke ju drejtuar pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kryen trajnimin, tha: "Ju duhet t'i përdoreni këto shkathtësi edhe nëse jeni jashtë detyrës, mos harroni atë që keni mësuar. Si ushtarë që jeni, ju gjithherë



duhet të jeni shembull dhe në gjendje për t'u përballuar në situata të vështira. Ju tani keni aftësi shtesë të cilat ju mund të përdorni për të marrë përgjegjësinë e një incidenti dhe të kujdeseni për njerëzit, pa marrë parasysh gradën e juaj". Trajnimin me profesionalizëm e kanë mbajtur instruktorë nga Mbretëria e Bashkuar të udhëhequr nga Derbyshire Stronge (International) Ltd dhe është financuar gjithashtu nga Ministria e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar". Në fund komandanti i FSK-së, falënderoi Mbretërinë e Bashkuar si dhe instruktorët që e kanë kryer me sukses këtë trajnim, shumë të nevojshëm për FSK-në. "Unë e falënderojë David Derbyshirë dhe ekipin e tij; Mike Kelly dhe Caroline, për mbështetje dhe trajnimin e tyre të shkëlqyer". Ndërsa këshilltari i Komandantit të FSK-së, nënkolonel Gregor Lindsay, pos tjerash, tha: " Ju tani keni një grup të gjerë të përgatitur të ndihmës së parë. Tani e dini se si të veproni; të matur dhe pa kurrfarë shqetësimi në raste të një incidenti, kur njerëzit janë të plagosur rëndë. Nëse ju gjeni veten në një incident të tillë, mos kini frikë, për të qenë personi i parë në vendngjarje, dhe që duhet t'i përdorni aftësitë tuaja profesionale. Çdo ushtar i cili përdor aftësitë e tyre në një situatë të tillë, të vështirë, do të jetë një kredi për FSK-në". Nënkolonel Lindsay përgëzoi pjesëtarët e FSK-së: "Ju jeni duke punuar shumë dhe pas përfundimit të provimeve me shkrim dhe ato praktike, ju keni arritur të njëjtin nivel të kompetencës si kolegët tuaj në Mbretërinë e Bashkuar. Ushtria britanike e sheh ndihmën e parë si një mision aftësi kritike për ushtarët që shkojnë në operacionet. Kjo është arsyeja pse juve ju duhet të merri njohuri nga ndihma e parë, në mënyrë serioze këtu në Kosovë. Në të ardhmen ne mund të veprojmë në operacionet e mbështetjes së paqes së bashku. Unë personalisht jam i kënaqur që të dini se në qoftë se unë do të shërbej së bashku me një prej jush e di se nëse plagosem në këtë mision, ju do të keni aftësi për të më mbajtur gjallë" tha në fund këshilltari i komandantit të FSK-së. FSK-ja gjatë pesë viteve të fundit ka kryer trajnime të drejtpërdrejta mjekësore, në nivele të ndryshme, nga Derbyshire Stronge. Gjatë dy javëve, 24 pjesëtarë janë trajnuar në trajnimin, personi i parë në skenë. Award Intermediate është një kualifikim i cili është i njohur ndërkombëtarisht, dhe është i përshtatshëm dhe mund të jetë shumë i dobishëm për të ndihmuar në aspirata afatgjata për të zhvilluar një aftësi mjekësore të vetë-qëndrueshme brenda FSK-së, por edhe në FAK. Është planifikuar që studentët më të mirë në këtë kurs, do të bëhen instruktorë mjekësorë, brenda njësive të tyre.

Kompania 2B e Batalionit të II-të të BRSH-së përfundoi me sukses trajnimin tremujor "Gjenerimi i Forcës"

Pjesëtarët e Kompanisë 2B të Batalionit të II-të të Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, me realizimin e ushtrimit fushor 72 orësh "UJKU VIGJILENT 01" përfunduan trajnimin e brendshëm tremujor "Gjenerimi i Forcës", i cili ka filluar më 16 janar 2017 dhe ka përfunduar më 30 mars 2017. Ushtrimi fushor i planifikuar nga Komanda e Batalionit të Dytë, u realizua në fshatrat e Komunës së Rahovecit dhe Malishevës(konkretisht në fshatrat Mrasor dhe Llapqevë), i cili është mbështetur edhe nga vëzhguesit e NALT-it, KFOR-it dhe kontrollues-vëzhguesit e KDS-së. Gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e Kompanisë 2B-dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht në operacionet ushtarake, siç janë: rikonicion të terrenit, pika të kontrollit, patrullimet me blinda, reagim në kontakt, kordon-kërkim, sulm i planifikuar i bazës së armikut në nivel togu, prita, mbrojtje gjatë marshimeve rrugore, vetëmbrojte të afërt, perimetër të sigurisë, navigim, marshime kondicionale të shpejta me peshë, baza patrulluese 24 orësh, poligon taktik, qitje e avancuar me municion real luftarak dhe fusha tjera. Gjatë trajnimit janë realizuar tri teste, me qëllim të vlerësimit të shkathtësive grupore dhe individuale të pjesëtarëve, si: teste fizike, teste akademike mbi njohuritë taktike dhe teste të përgjithshme. Ushtrim fushor "Ujku Vigjilent 01", ishte produkt i trajnimit tremujor të kompanisë, ku gjatë kësaj kohe pjesëtarët e kompanisë rifreskuan dhe realizuan tema të reja taktike profesionale- ushtarake. Këto trajnime kanë për qëllim mbajtjen në nivel të pjesëtarëve të FSK-së dhe rritjen e gatishmërisë së tyre.



Instruktorë nga KFOR-i amerikan realizuan trajnimin dyjavor në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së

Në kuadër të bashkëpunimit mes Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) dhe Grupit Shumëkombësh Luftarak Lindje (Bondstill) është realizuar një trajnim i cili përmban një cikël ligjëratash nga fusha ushtarake. Gjatë periudhës 13-23 mars 2017 janë realizuar ligjërata lidhur me procesin e vendimmarrjes ushtarake, ku kanë marrë pjesë oficerë dhe nënoficerë të KDS-së. Gjatë trajnimit, instruktorët amerikanë kanë punuar në ekip me pjesëtarët e KDS-së, me qëllim që trajnimi të jetë sa më efikas dhe pjesëtarët të marrin sa më shumë njohuri nga kjo fushë. Pas përfundimit të trajnimit, është mbajtur edhe ceremonia e certifikimit, ku ishin të pranishëm: komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi; kolonel Irfete Spahiu, zëvendëskomandant i KDS-së; komandanti i Bondstillit kolonel Cory Lusk; nënkolonel Scott Virgil nga kampi ushtarak në Novosellë, si dhe oficerë të lartë të KDS-së dhe të KFOR-it amerikan. Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi falënderoi komandantin e Bondstillit për angazhimin e pjesëtarëve të tij në realizimin e këtij trajnimi, ndërsa theksoi se "pjesëtarët e kampit Bondstill janë duke kontribuuar në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin dhe avancimin e pjesëtarëve të KDS-së për çka ju jemi mirënjohës, ne kemi pas edhe në të kaluarën bashkëpunim me kampin



Bondstill dhe më vjen mirë që tashmë është krijuar edhe një traditë e bashkëpunimit mes dy kazermave. Ne jemi të përkushtuar që të vazhdojmë këtë bashkëpunim dhe vlerësoj se mbështetja juaj në lëmin e stërvitjeve është e nevojshme të ndodhë edhe në të ardhmen". Komandanti i Bondstillit-kolonel Cory Lusk në fjalën e tij tha, se "ne kemi përzgjedhur një ekip të përgatitur mirë për realizimin e trajnimit, bazuar në kërkesën tuaj dhe planifikimin mes dy shtabeve, për çka sot po flasin edhe rezultatet. Ai gjithashtu theksoi se ka vlerësime pozitive për përvojën e pjesëtarëve të KD-së, por edhe për interesimin e treguar për të marrë njohuri sidomos në fushën e vendimmarrjes ushtarake". Në kuadër të ceremonisë, për rolin e këtij trajnimi foli shefi i Shtabit të KDS nënkolonel Fadil Hoxha, i cili përmes një prezantimi të shkurtër paraqiti të arriturat nga ky trajnim, i cili u vlerësua si shumë frytdhënës. Ceremonia e certifikimit mbaroi me shpërndarjen e diplomave për pjesëtarët pjesëmarrës, ndërsa komandanti i KDS gjeneral brigade Enver Cikaqi ndau mirënjohje për instruktorët amerikanë, në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë gjatë këtyre dy javëve.

Në FSK u mbajt takimi i deputetit Qerim Bajrami me pjesëtarët e FSK-së nga komuniteti boshnjak

Zyra për Çështje të Komuniteteve në MFSK, kryesuar nga drejtoresha zonja Azemina Çullum mbajti takim me temën: ,,Pozita dhe statusi i pjesëtarëve të komunitetit boshnjak në Forcën e Sigurisë së Kosovës" ku mori pjesë edhe deputeti Qerim Bajrami, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, si dhe anëtar i Komitetit për të Drejtat, Interesat dhe Kthimin e Komuniteteve. Me këtë rast, zv. ministri Muhamet Latifi, në fjalën e tij theksoi se FSK është institucion i shteti të Kosovës dhe gjithë qytetarëve të saj pa dallim nga përkatësia racore, gjinore, nacionale dhe fetare, duke shpre-



hur admirimin për punën dhe përkushtimin e pjesëtarëve të FSK-së nga të gjitha komunitetet e në veçanti të komunitetit boshnjak i cili është i integruar mirë në FSK. Nga ana e tij, drejtori i drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi u shpreh se FSK-ja është unike në strukturën e saj, në të cilën kontribuojnë pjesëtarë nga radhët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në vendin tonë. Deputeti Qerim Bajrami, u shpreh se shërbimi i pjesëtarëve nga komuniteti boshnjak në FSK është krenari për komunitetin boshnjak dhe gjithashtu do të jetë nderë e krenari edhe shërbimi në Ushtrinë e ardhshme të Kosovës, dhe se komuniteti boshnjak duhet të angazhohet që të jep kontributin në zhvillimin dhe avancimin e institucioneve të vendit si dhe pjesëmarrjen dhe avancimin e pozitës së tyre. Edhe deputeti Nuredin Ibishi, anëtarë i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen Parlamentare të FSK-së, në diskutimin e tij u interesua për pozitën e komuniteteve në FSK si dhe shprehu mbështetjen për angazhimet e MFSK-së dhe FSK-së në realizmin e politikave që garantojnë perspektivë dhe trajtim të barabartë. Në këtë takim për përvojat dhe pozitën e tyre në FSK diskutuan pjesëtarët e FSK-së nga radhët e komunitetit boshnjak si: toger Edin Januz, nëntoger Ilhan Zoraniq dhe ushtare Jasmina Shabanoviq. Në takim mori pjesë edhe zëvendës drejtori i ekipit këshillues të NATO-s për MFSK dhe FSK (NALT), z. Mark Theobald si dhe oficerë e zyrtarë të tjerë nga ministria për FSK dhe FSK-ja.

Përfundoi trajnimi i përbashkët në fushën e komunikimit mes FSK-së dhe Brigadës Shumëkombëshe Lindje

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, nga data 09 deri më 10 mars, është realizuar trajnimi i përbashkët në fushën e komunikimit mes FSK-së dhe ekipit mobil të Brigadës Shumëkombëshe Lindje të kampit Bonstill nga Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Të pran-



ishëm gjatë trajnimit ishin zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandanti i Brigadës Shumëkombëshe Lindje kolonel Jeffrey SUVER, shefi i Departamentit të Komunikimit të KFT-së nënkolonel Gyrner Murati dhe përgjegjësi për komunikim në kuadër të Brigadës Shumëkombëshe Lindje major Work Walter si dhe oficerë të FSK-së dhe KFOR-it. Ky trajnim kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe vendosjen e komunikimit të përbashkët për realizimin e ushtrimit fushor ,,Silver Sabre 3", i cili do të organizohet nga KFOR-i dhe është në vazhdën e mbështetjes që është duke dhënë Ushtria amerikane për Forcën e Sigurisë së Kosovës në të gjitha fushat. zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, u shpreh i kënaqur me bashkëpunimin e FSK-së me Ushtrinë amerikane, duke theksuar në veçanti rëndësinë e bashkëveprimit me kampin Bonstill rreth pajisjeve të komunikimit. Ndërkaq, zëvendëskomandanti Brigadës Shumëkombëshe Lindje, kolonel Jeffrey SUVER, u shpreh se ndjehet mjaft i kënaqur me bashkëpunimin me Forcën e



Sigurisë së Kosovës, për sa i përket përgatitjes së pjesëtarëve të FSK-së me pajisje moderne në lëmin e komunikimit. Në fund, zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore dhe zëvendëskomandanti Brigadës Shumëkombëshe Lindje, theksuan se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen përmes shkëmbimit të përvojave dhe organizimit të ushtrimeve në këtë fushë.

Në Brigadën e Mbështetjes Operacionale të FSK-së përfundoi gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë

Nga data 7 deri më 10 mars është realizuar gara "Ushtari më i mirë" në kuadër të BMO-së dhe njësive të saj, ku morën pjesë 11 pjesëtarë nga njësitë e BMO-së, Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Batalioni i Logjistikës dhe Batalioni i Xhenios. Në ceremoninë përmbyllëse të pranishëm ishin edhe Zv. KOM FT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ZV. KOM i BMO-së, nënkolonel Avdi Rraci, KOM i Regjimentit kolonel Shaip Haziri, komandantët e njësive të lartpërmendura si dhe rreshter majorët e këtyre njësive. Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli në fjalën e tij, të mbajtur me këtë rast, ndër të tjera tha: "Të arriturat tona janë duke u vërejtur çdo ditë, falë punës dhe përkushtimit tonë nuk po na mungojnë as rezultatet. Organizimet e tilla duhet të na shërbejnë si motiv në të ardhmen. Andaj ju përgëzoj të gjithëve, ju qe keni organizuar këtë garë dhe ju që keni shprehur guximin për të marrë pjesë dhe për t'u sfiduar. Organizimi i garës "Ushtari më i mirë" është shtrirë nëpër të gjitha njësitë e FSK-së. Dua t'ju garantoj se është interesim yni që të vlerësohen kualitetet që jeni duke i treguar, ju do të jenë një udhërrëfyes i mirë në ngritjen e standardeve në kuadër të FSK-së". ZV Komandanti i BMO-së kolonel Avdi Rraci shtoi se gara e organizuar ka karakter sfidues dhe është realizuar edhe në kuadër të BMO-së. Prandaj synimi ynë në garën e përgjithshme është që të arrijmë rezultate sa më të mira. Rreshter majori i parë i komandantit të FSK-së, Genc Metaj, e vlerësoi lart organizimin e kësaj gare, duke theksuar se gara "Ushtari më të mirë" do të ketë karakter ndërkombëtar dhe do të marrin pjesë edhe shumë vende tjera partnere me FSK-në, ku do të ketë edhe shtim të aktiviteteve dhe disiplinave që do të organizohen në kuadër të kësaj gare për vitin 2017. Kjo garë është realizuar në disa lokacione në këto disiplina: Testi fizik, Navigim tokësor, Ndihmë e parë, Kalimi i zonës së rrezikshme, Hedhja e granatës, Vëzhgimi i terrenit, Marshimi 15 km me ngarkesë10 kg. Në fund të ceremonisë u ndanë mirënjohje për tri vendet e para: Vendi i tretë i takoi ushtarit Albert Krasniqi- Batalioni i Logjistikës, Vendi i dytë i takoi ushtarit Hazir Aliu-Batalioni i Xhenios Vendi i parë i takoi ushtarit Besnik Nebihu-Regjimenti i Mbrojtjes Civile



Intervistë me Ahmet Sallovën shef i Sektorit-Qendra Koordinuese për Deminim në MFSK

FSK-ja shkatërroi qindra mjete të pashpërthyera gjatë vitit 2016

Kompania e Deminimit të FSK-së, që nga viti 2010, ka pastruar shumë fusha të minuara, gjatë luftës, si dhe ka shkatëruar mijëra mjete të paekspoduara të gjetura në shumë lokacione në Kosovë, ku si pasojë e tyre, kanë humbur jetën shumë qytetarë të pafajshëm në Kosovë. Për këtë biseduam me Ahmet Sallovën-shef i Qendrës Koordinuese për Deminim në MFSK.



Gazeta "Forca Jonë": *Z. Sallova, cila është Qendra Koordinuese për Deminim në Ministrinë e FSK-së?*

Ahmet Sallova: Qendra Koordinuese për Deminim (QKD) është njëri nga katër sektorët e Departamentit të Operativës dhe Trajnimit brenda Ministrisë së FSK-së. Qendra Koordinuese për Deminim bazuar në Ligjin Nr.04/L-089 për deminim humanitar është autoritet koordinues për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të deminimit humanitar të zhvilluar nga FSK dhe organizatat e tjera në Republikën e Kosovës.

Gazeta "Forca Jonë": *Sa fusha kanë pastruar dhe sa mjete eksplozive kanë eliminuar njësitet e deminimit të FSK-së ?*

Ahmet Sallova: Kompania e Deminimit e FSK-së ka filluar operacionet e deminimit që nga viti 2010, ku falë punës profesionale të pjesëtarëve të saj, ka arritur të pastrojë mbi 1,745,465 metra katrorë nga mbi 2177 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera, duke filluar nga minat anti- personale, minat antitank, projektil të ndryshme, granata e municione të tjera të pashpërthyera. Ndërkaq, gjatë vitit 2016, Kompania e Deminimit ka bërë pastrimin e mbi 247,213 metrave katrorë, duke shkatërruar gjithsej 72 mjete të ndryshme të pashpërthyera, në pesë lokacione, si: në Parkun e Lirisë në Ferizaj, në Zagrmle të Pejës, në Hoçë të Prizrenit, në kazermën e FSK-së-në Ferizaj dhe në Paldenicë"., na thotë në fillim të bisedës z. Sallova. "Prej fillimit të operacioneve të çminimit të fushave të minuara, njësitet e FSK-së kanë pastruar 23 lokacione të ndryshme, edhe pse shumë nga fushat të njohura si të rrezikshme janë pastruar, ende ekzistojnë edhe 111 zona të afektuar nga minat dhe nga bombat kasetë".



Gazeta "Forca Jonë": *Cili është roli i ekipeve të EOD-së?*

Ahmet Sallova: Përveç njësive që zhvillojnë operacionet e çminimit humanitar FSK ka edhe dy njësi të EOD-së njëra në Prizren dhe tjetra në Pomozotin, të cilat 24 orë në 7 ditë kujdestarojnë për intervenime në rastet kur qytetaret hasin në mjete të ndryshme eksplozive dhe lajmërojnë për largimin e tyre. Gjatë vitit 2016 FSK ka intervenuar në 307 raste duke demoluar 371 mjete të ndryshme eksplozive.

Që nga fillimi i këtyre operacioneve pra nga viti 2010 FSK ka intervenuar në 2136 raste dhe ka demoluar 3150 mjete të ndryshme eksplozive.

Gazeta "Forca Jonë": *Sa është numri i personave të cilët kanë pësuar nga këto mjete eksplozive?*

Ahmet Sallova: Nuk duhet të harrojmë faktin se që nga koha e përfundimit të luftës e deri më sot, 117 persona kanë humbur jetën dhe 461 të tjerë janë lënduar si pasojë e minave ose mjeteve eksplozive, njofton z. Sallova.

Puna e njësive të FSK-së është shumë më rëndësi, duke marr parasysh edhe faktin se Kompania e Deminimit bën vetëdijesimin e nxënësve në sholla fillore, se si ata duhet të sillen në raste kur hasin në mina apo mjete tjera eksplozive dhe se si t'i raportojnë ato tek autoritetet përgjegjëse, duke shmangur kontaktin e drejtpërdrejt me to.

Gazeta "Forca Jonë": *z. Sallova, cila është Kompania e Deminimit në aspektin profesional?*

Ahmet Sallova: Kompania e Deminimit përbehet nga katër togje. Tri togje janë të trajnuara dhe të aftësuara për deminim humanitar dhe pastrimin e fushëbetejave (BAC), kurse një tog është aftësuar përveç kryerjes së deminimit humanitar edhe për kryerjen e detyrave për eliminimin e mjeteve të ndryshme eksplozive të pashpërthyera (EOD). Çdo tog i ka nga 25 pjesëtarë. Të gjitha këto njësi janë shumë profesionale dhe të përgatitura sipas standardeve ndërkombëtare për deminim, si dhe janë të pajisura me pajisje të nevojshme, ku shumica prej tyre kanë qenë donacione nga SHBA-të.

FORCA JONË

* * * Viti VI • Nr. 57 • Maj 2017 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i FSK-së Haki Demolli u takua me Ministrin e Mbrojtjes të Kroacisë, Damir Krstiqeviq

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli, më 28 prill 2017, u takua në Split, me Ministrin e Mbrojtjes të Kroacisë, zotëri Damir Krstiqeviq.

Ministri Demolli fillimisht falënderoi Ministrin Damir Krstiqeviq për ftesën si dhe për gjithë angazhimin e tij personal dhe të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë në drejtim të avancimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë. Nga ana e tij, ministri Demolli, tha gjithashtu; "se roli i Kroacisë si vend anëtar i NATO-s, përkatësisht roli i Ministrisë së



Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura Kroate, është jashtëzakonisht i rëndësishëm krahas edhe partnerëve tjerë strategjik, për ngritjen, avancimin si dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në iniciativa dhe organizma rajonal dhe më gjerë të sigurisë. Gjithashtu, ministri Demolli, u shpreh se Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës si dy institucione për të cilat Republika e Kosovës është duke u angazhuar që t'i avancojë në mandat dhe detyra, dhe duke qenë se për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura përveç vullnetit të brendshëm nevojitet edhe transparencë për procesin si dhe mbështetje nga partnerët strategjik të Republikës së Kosovës dhe vendeve siç është Kroacia e cila ka mbështet FSK-në, që nga ngritja e saj dhe vazhdon të jetë një prej vendeve që ofron shumë përkrahje.

Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes të Kroacisë, zotëri Damir Krstiqeviq falënderoi ministrin Demolli, për vizitën si dhe shprehu gatishmërinë që marrëdhëniet e mira bilaterale ndërmjet dy institucioneve dhe dyja shteteve do t'i avancojnë më tutje edhe me një përkushtim edhe më të madh edhe në të ardhmen. Gjatë vizitë në Kroaci, ministri i FSK-së, z.Haki Demolli takoi edhe dy nënoficerët e FSK-së, të cilët gjenden për shkollim atje: rreshter major i komandës Xhevdet Mataj dhe rreshter major Rexhep Bytyqi. Ministri Demolli i shoqëruar edhe nga këshilltari i tij ushtarak, kolonel Fadil Hadergjonaj po qëndron në Kroaci, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, zotëri Damir Krstiqeviq, dhe ka marrë pjesë në panairin e 4-të të Mbrojtjes dhe Hapësirës Ajrore të Detit Adriatik (ASDA 2017), i cili u mbajt në Split.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama priti komandantin e Gardës së Ohajo-s gjeneralmajorin John Harris

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 25 prill 2017, priti në takim pune komandantin e Gardës Kombëtare të Ohajos së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), gjeneralmajor John Harris, i shoqëruar nga atasheu ushtarak amerikan pranë ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, kolonel Jeffery Fischer si dhe oficerë tjerë të lartë. Gjeneral Rama me këtë rast e ka falënderuar gjeneralin Harris për kontributin që Ushtria Amerikane është duke dhënë në kuadër të KFOR-it, për 18 vjet me radhë, në mënyrë që në Kosovë të ketë një ambient të qetë dhe të sigurt. Po ashtu, gjeneral Rama ka shprehur mirënjohjen e tij për kontingjentin amerikane nga kampi ushtarak „Bondsteel" për përkrahjen e dhënë FSK-së në përgjithësi dhe në veçanti për zhvillimin e kapaciteteve trajnuese të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së (TRADOK) në Ferizaj. Gjatë takimit Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama e ka njoftuar gjeneralin Harris edhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK),



përgatitjet e bëra, planifikimet dhe procedurat që janë zhvilluar deri në sot, si nga ministria ashtu edhe në nivel qeveritar e shtetërorë. Me këtë rast ai e njoftoi gjeneralin Harris edhe me përqindjen e lartë të numrit të komuniteteve pakicë që janë duke shërbyer në radhët e FSK-së si dhe me aktivitetet konkrete që janë duke u bërë për inkuadrimin e sa më shumë pjesëtarëve të rijnë të komuniteteve pakicë. Gjeneral Harris është ndarë i kënaqur me arritjet e FSK-se sidomos me zhvillimin e pjesëtarëve të saj. Është mbresëlënëse tha ai, që pjesëtarët e FSK-së janë shumë të suksesshëm në shkollat dhe kurset ndërkombëtare ku po marrin çmime të larta për përformancën e shkëlqyer. Po ashtu gjenerali Harris shprehi gatishmërinë për të përkrahur FSK-në në zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të saj.

Në FSK u mbaj Konferenca "FSK-Partnerët"

Ministri Demolli: Vendet partnere kanë rol të madh në avancimin profesional dhe rritjen e kapaciteteve të FSK-së

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), më 20 prill 2017, filloi punimet konferenca treditore, e gjashta me radhë, „FSK dhe Partnerët", me pjesëmarrje të përfaqësuesve të ushtrive të vendeve partnere të MFSK-së dhe FSK-së dhe institucioneve vendore të fushës së sigurisë. Me këtë rast, në fjalën e hapjes së punimeve të konferencës, ministri Haki Demolli tha se, qëllimi i konferencës „FSK dhe Partnerët" është rritja e bashkëpunimit të MFSK/FSK-së dhe shteteve partnere si dhe sinkronizimi i aktiviteteve në mënyrë që MFSK dhe FSK të kenë mbështetje për t'u zhvilluar në Forcë të aftë dhe profesionale. Më tej, ministri Demolli tha se shtetet, përkatësisht ushtritë partnere të FSK-së kanë një rol të madh në avancimin e aftësive dhe kapaciteteve të saj. Zotëri Demolli shtoi gjithashtu se, të gjitha arritjet FSK-ja i ka bërë në bashkëpunim me partnerët e saj bilateral dhe me mbështetjen e tyre të përditshme, në përputhje të plotë me standardet e NATO-s. Ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, duke folur për procesin e transformimit tha se, zhvillimi i FSK-së në një fazë të ardhshme është thelbësore për Republikën e Kosovës, për qytetarët dhe komunitetet që jetojnë këtu. „Ne mund të qëndrojmë të gatshëm të mbështesim institucionet tona, duke arritur qëllimin tonë për të qenë një Forcë për të mirën e vendit tonë, kontribuuese e paqes dhe sigurisë në rajon dhe për t'u përballur me sfidat e sigurisë së bashku për një botë më të sigurt". Në fund, ministri Demolli tha se MFSK dhe FSK në këtë konferencë do të paraqesin para jush arritjet, kërkesat për mbështetje në fushat të cilat i kemi identifikuar si më të rëndësishme për t'i zhvilluar më tej aftësitë tona, dhe besoj shumë, ashtu siç deri më tani, mbështetja juaj do të jetë e fuqishme. Ndërsa, në fjalën e tij komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama falënderoi atashetë ushtarakë të vendeve partnere, pjesëmarrëse në konferencë, për kontributin e vazhdueshëm që vendet e tyre kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin për ndërtimin, zhvillimin dhe profesionalizmin e FSK-së. Me nga një fjalë përshëndetëse në konferencë u paraqitën edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral Giovani Fungo dhe drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për MFSK/FSK-në, gjeneral Dietmar Mosmann. Në seancën plenare, kryesuesi i konferencës, nënkolonel Ali Krasniqi, ushtrues i detyrës së drejtorit të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri prezantoi të arriturat e fundit të FSK-së në fushën e bashkëpunimit dhe sigurisë, ndërsa nënkolonel Enver Voca paraqiti një ekspoze të angazhimeve të FSK-së në ushtrimet jashtë vendit. Ndërkaq, atashetë e vendeve si Shqipëria, Kroacia, Gjermania, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e



Bashkuara të Amerikës, oficerët kolonel Ahmet Leka, nënkolonel Mladen Cernicki, nënkolonel Martin Herrmann, nënkolonel Rusen Abidinoglu, nënkolonel Richard Perry dhe nënkolonel Brian Delvin paraqitën propozim-ofertat dhe kapacitetet mbështetëse, të cilat janë vënë në dispozicion të Forcës së Sigurisë së Kosovës për vitin 2017 dhe 2018. Në konferencën „FSK dhe Partnerët" po marrin pjesë atashetë e akredituar në Kosovë dhe rajon të shteteve partnere si: Shqipëria, Kroacia, Belgjika, Sllovenia, Republika Çeke, Gjermania, Hungaria, Italia, Japonia, Maqedonia, Holanda, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe atashetë e FSK-së të akredituar në SHBA, Turqi, Belgjikë, Shqipëri, Suedi, Gjermani dhe Turqi, gjithashtu edhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integrimeve Evropiane, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave.



Ministri Haki Demolli takohet me presidenten kroate, Kolinda Grabar -Kitaroviq

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, z.Damir Krstiqeviq, po qëndron për një vizitë zyrtare në Kroaci për të marrë pjesë në panairin e 4-të të Mbrojtjes dhe Hapësirës Ajrore të Detit Adriatik(ASDA 2017), i cili mbahet në Split. Ministri Demolli gjatë qëndrimit atje, zhvilloi një takim edhe me presidenten e Republikës së Kroacisë, znj. Kolinda Grabar-Kitaroviq. Në takimin e përbashkët ministri Demolli dhe presidentja kroate, znj.Kitaroviq, biseduan për marrëdhëniet e mira në mes dy vendeve, me theks të veçantë në fushën e sigurisë, si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë. Ministri Demolli, në kuadër të vizitës së tij, pritet të vazhdojë agjendën e takimeve me personalitete të rëndësishëm të shtetit kroat dhe shteteve tjera pjesëmarrëse.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në ceremoninë e diplomimit të kadetëve të FSK-së në Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst në Londër

Nëntoger Xhevahir Hasanaj fitoi medaljen "Kadeti më i mirë ndërkombëtar" në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama në kuadër të vizitës zyrtare në Mbretërinë e Bashkuar, më 13 prill 2017, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të kadetëve-oficerë në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst, ku diplomuan nëntogerët e FSK-së; Xhevahir Hasanaj dhe Arlind Bajrami. Kryeministrja e Mbretërisë së Bashkuar zonja Theresa May ishte ajo e cila i inspektoi kadetët dhe në emër të lartmadhërisë së saj Mbretëreshës Elisabetë, ndau medalje për nëntogerin Xhevihir Hasanaj si dhe certifikata për kadetët të cilët mbaruan studimet atje. Me rastin e dhënies së medaljes oficerit të FSK-së, Xhevahir Hasanajt, kadetit me rezultatet më të larta nga të gjithë oficerët-kadetë ndërkombëtarë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se, rezultati i shkëlqyer i oficerit të FSK-së ka rëndësi të veçantë jo vetëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës por edhe për gjithë Kosovën. "Jam i privilegjuar që gjendem sot, këtu, në cilësinë e komandantit, për të nderuar këtë ngjarje madhështore të organizuar nga kjo Akademi me nam, e cila çdoherë po nxjerr oficerë që po na



bëjnë krenarë me rezultatet e tyre",- tha gjeneral Rama. Në këtë ceremoni përveç komandantit të FSK-së, gjeneral Rama, ishte i pranishëm edhe Presidenti i Republikës, zotëri Hashim Thaçi; ambasadori i Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, zotëri Lirim Graiçevci; pastaj kolonel Xhevahir Geci, ushtrues detyre i komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë(BRSH), nënkolonel Ali Krasniqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim e Siguri në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe nënkolonel Gregor Lindsay. Pas 12 muajsh shkollimi në Akademinë Mbretërore Ushtarake në Sandhurst të Britanisë së Madhe, sot oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Xhevahir Hasanaj fitoi medaljen " Kadeti ndërkombëtar më i mirë". Kjo është hera e dytë që një oficer kadet nga Kosova fiton çmim si kadeti më i mirë ndërkombëtar, duke pasur parasysh që në vitin 2015 nëntoger Ismail Hoxha pati fituar shpatën e argjendtë.

Ministri Haki Demolli zhvilloi takim me deputetët e Parlamentit Evropian

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Haki Demolli, në Ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 20 prill 2017, zhvilloi takim me deputet e Parlamentit Evropian, z. Tonino Picula nga Kroacia, z. Angle Dizhambazki nga Bullgaria, z. Lars Adaktusson dhe z. Jasenko Selimoviq nga Suedia, z. Julie Ward nga Mbretëria e Bashkuar, z. Igor Soltes nga Sllovenia të shoqëruar edhe nga shefja e Zyrë së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalia Apostolava. Në takimin e përbashkët të Ministrit Demolli dhe deputetëve të Parlamentit



Evropian u bisedua për aspektet e sigurisë në vend, dhe procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, si dhe për përfshirjen e komuniteteve pakicë në FSK-së dhe barazinë gjinore brenda institucionet tonë. Ministri Demolli i informoi deputetët e Parlamentit Evropian mbi përgatitjet, diskutimet dhe planet e Ministrisë për FSK për transformimin e FSK-së në FAK duke theksuar se „Plani ynë rreth transformimit është plotësisht transparent dhe i koordinuar mirë me partnerët tanë strategjik".Gjithashtu, ministri Haki Demolli i njoftoj euro deputetët edhe mbi të arriturat dhe sukseset në integrimin e komuniteteve në FSK e gjithashtu edhe për vëmendjen që i kushtohet barazisë gjinore në MFSK dhe FSK. Më tej, Ministri Demolli lidhur më këtë tha se është në fazën finale përgatitja e strategjisë për përfaqësimin e komuniteteve dhe sistemimin e ngritjen ne karrierë të pjesëtarëve të komuniteteve që tashmë janë pjesë e FSK. Në takim, përveç ministrit Haki Demolli morën pjesë edhe zëvendësministri i MFSK-së, z. Muhamet Latifi, ambasadori i Kosovës në Belgjikë, z. Bernard Nikaj dhe shefi i kabinetit të Ministrit, z. Latif Leka. Në fund, deputet falënderuan ministrin e FSK-së Haki Demollin për takimin produktiv dhe shprehen falënderimin e tyre ndaj ministrit dhe institucionit

Ministri Haki Demoli dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama bënë homazhe në Koshare

Të dielën, më 09 prill 2017, ministri Haki Demoli dhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Rrahman Rama të shoqëruar nga zëvendësministri Muhamet Latifi, kanë marrë pjesë në manifestimin "Ditët e shqipes" që u kushtohet luftëtarëve të rënë të "Brigadës 138 Agim Ramadani", në betejën e UÇK-së në Koshare, manifestim ky i organizuar nën patronatin e kryeministrit të Qeverisë së Kosovës Isa Mustafa. Me këtë rast ministri dhe komandanti së bashku me bashkëpunëtorë banë homazhe në varrezat e dëshmorëve në kompleksin memorial në Koshare. Po ashtu ata takuan shumë familjarë të dëshmorëve me të cilët biseduan përzemërsisht duke shprehur mirënjohjen për sakrificën sublime të dëshmorëve të rënë në altarë të lirisë në luftën çlirimtare dhe respekt për pasardhësit dhe familjarët e tyre. Ata vlerësuan lartë të rënët në këtë betejë të lavdishme e cila theu kufirin e imponuar forcërisht ndërmjet shqepëtave, betejë që së bashku me të gjitha betejat e luftës së UÇK-së i sollën lirinë Kosovës. Liri të cilën e gëzojmë ne sot në Kosovën e lirë dhe të pavarur, që ishte ëndrra dhe amaneti i të gjithë dëshmorëve të luftës së UÇK-së. Pjesëmarrës në këtë manifestim dhe pjesë e delegacionit të MFSK-së dhe FSK-së ishin edhe zëvendës komandanti i Komandës së Forcës Tokësore të FSK-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj shef i departamentit të Operativës dhe Trajnimeve, kolonel Fadil Hadergjonaj këshilltar ushtarak i ministrit, këshilltarët politik Rexhep Leci dhe Shkelzen Feka. Në kuadër të organizimit të manifestimit kanë mbajtur fjalime; presidenti i Kosovës zoti Hashim Thaçi, kryeministri i Kosovës zoti Isa Mustafa dhe ish komandanti i "Brigadës 138 - Agim Ramadani"



të UÇK-së Rrustem Berisha. Manifestimi u përmbyll me pika muzikore dhe artistike me tematikë nga beteja e lavdishme e Koshares dhe heroizmi i të rënëve në luftën çlirimtare.

FORCA JONË


Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Zëvendësshefi i shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjeneral brigade Dedë Prenga vizitoi Forcën e Sigurisë së Kosovës

Drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjeneral brigade Zymer Halimi, zëvendës komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe shefi i Operativës nga Komanda e Forcave Tokësore, kolonel Bashkim Shillova, më 14 prill 2017, pritën në vizitë zëvendësshefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneral brigade Dedë Prenga. Vizita është realizuar në kuadër të bashkëpunimit ushtarak në mes dy vendeve. Me këtë rast oficerët e lartë nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë u njoftuan për të arriturat e Forcës së Sigurisë së Kosovës në të gjitha fushat e angazhimit, operacional dhe taktik, procesin e transformimit të FSK-së dhe sfidat e saj. Në këtë takim u çmua lartë bashkëpunimi i ndërsjellët në mes dy vendeve dhe të dy palët u dakorduan për thellimin e bashkëpunimi për të ardhmen në të gjitha fushat, me interes të avancimit të sigurisë rajonale dhe globale.



Gjeneral Gëzim Hazrolli priti në vizitë komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it në Kosovë



Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore(KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, më 25 prill 2017, ka pritur në takim, në ambientet e kazermës "Adem Jashari", komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it në Kosovë, kolonel Jochen Gumprich, të cilin e njoftoi për rrjedhat aktuale në Forcën e Sigurisë së Kosovës, e në veçanti në Komandën e Forcave Tokësore, si dhe për aktivitetet që janë duke u realizuar dhe ato të cilat janë në planifikim për të ardhmen. Gjeneral Hazrolli e falënderoi komandantin e kontingjentit gjerman kolonelin Gumprich për kontributin dhe mbështetjen që, ai dhe vendi i tij, i ka dhënë në vazhdimësi Forcës së Sigurisë së Kosovës, që nga themelimi i saj në vitin 2009 e deri më sot, duke e ndihmuar në ngritjen e saj profesionale në të gjitha fushat, qoftë me trajnime të ndryshme dhe shkëmbim përvojash, qoftë me donacione. Koloneli Jochen Gumprich falënderoi gjeneral Hazrollin për pritjen dhe bashkëpunimin, duke theksuar se Gjermania në vazhdimësi ka qenë mbështetëse e shtetit të Kosovës dhe FSK-së dhe se këtë bashkëpunim do ta vazhdojë edhe në të ardhmen.

Kontingjenti i Forcës së Sigurisë të Kosovës merr pjesë në Ushtrimin "Biza 17-01" në Shqipëri

Një kontingjent prej 12 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës u nisën më 11 prill 2017, për në Republikën e Shqipërisë, për të marrë pjesë në Ushtrimin "Biza 17-01", ushtrim Vendkomandë / i asistuar me kompjuter. Ky ushtrim do realizohet në dy periudha nga 09-14.04.2017 dhe 17-20.04.2017 në Qendrën Simulantëve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Tiranë, ushtrimi do realizohet në madhësi të Grup batalionit të këmbësorisë. Për t'i përshëndetur dhe uruar suksese pjesëtarëve që do marrin pjesë në këtë trajnim të pranishëm ishin edhe shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri si dhe shefi i Operatives të KFT-së, kolonel Bashkim Shillova. Më këtë rast kolonel Haziri ju uroj suksese pjesëmarrësve dhe njëherë kërkoi nga ta angazhim maksimal gjatë këtyre dy javëve, duke shtuar "Forca e Sigurisë së Kosovës nuk merr pjesë vetëm simbolikisht në trajnime të tilla por gjithmonë arrijnë të tregojnë rezultate të larta në trajnime të ndryshme, edhe nga ju kërkoji që të ktheheni me rezultate të shkëlqyera, dhe të jeni të gatshëm që njohurit e fituara gjatë këtyre ditëve t'i implementoni edhe në FSK". Ndër tjera shefi i Shtabit të KFT-së, kërkoj që pjesëtarët e FSK-së të tregojnë disiplinë, të bashkëpunojnë ndërmjet vetë dhe të respektojnë urdhrat e udhëheqësit të tyre. Ky ushtrim si dhe ushtrime të mëhershme janë duke u realizuar në kuadër të bashkëpunimit Bilateral që Republika e Kosovës, përkatësisht Forca e Sigurisë së Kosovës ka me Republikën e Shqipërisë dhe Forcat e saj të Armatosura.



Zyrtarët për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të FSK-së dhe KFOR-it mbajtën takim të përbashkët

Në organizim të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak(BCU) të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), më 27 prill 2017, në mjediset e Ministrisë u mbajt takimi i radhës i përfaqësuesve të KFOR-it, ku pjesëmarrës ishin ekipet e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak(CIMIC), JRD, LMT të KFOR-it dhe Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për MFSK/FSK (NALT). Fillimisht nga një fjalë rasti mbajtën drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi dhe drejtori i Departamentit të BCU, zotëri Hajrush Kurtaj. Gjeneral Halimi gjatë fjalës së tij vlerësoi lartë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të BCU-së të MFSK-së dhe NALT-it me ekipet e CIMIC të KFOR-it. Ai po ashtu u shpreh se vazhdimi i këtij bashkëpunimi forcon frymën e bashkëpunimit edhe me qytetarët e Kosovës dhe në dobi të tyre. Në vazhdim të takimit, zyrtari i Departamentit për Bashkëpunim Civilo - Ushtarak të MFSK/FSK, zotëri Agron Durmishi bëri një prezantim të hollësishëm të aktiviteteve të BCU-së në këtë fushe me mjaft rëndësi për MFSK-në dhe FSK-në. Gjithashtu lidhur me punën dhe aktivitetet rreth fushës së bashkëpunimit referuan edhe oficerët dhe nënoficerët e KFOR-it, NALT-it, JRD-së dhe LMT-së. Qëllimi i këtij takimit ishe koordinimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes ekipeve të BCU-së të MFSK/FSK-së dhe CIMIC-ut të KFOR-it, për realizimin e projekteve të përbashkëta në muajt në vazhdim.



Nëntogeri i FSK-së, Xhevahir Hasanaj shpallet kadeti më i mirë i huaj në Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst në Britani të Madhe

Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës nëntoger Xhevahir Hasanaj më 13 prill 2017, morri çmimin e kadetit më të mirë në fushën ushtarake, akademike dhe praktike në Akademinë prestigjioze Sandhurst të Mbretërisë së Bashkuar. Çmimin nëntogerit Xhevahir Hasanajt, ia dorëzoi kryeministrja e Britanisë së Madhe, znj. Theresa May. Këtë viti në Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst në Britani të Madhe kanë diplomuar dy oficerë të rinj të FSK-së, Xhevahir Hasanaj dhe Arlind Bajrami. Ndryshe, kjo është hera e dytë që kadetët e FSK-së marrin këtë çmim në Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst në Britani të Madhe. Herën e parë kadeti më i mirë ishte shpallur oficeri i FSK-së, Ismail Hoxha i cili kishte pranuar çmimin "Shpata e Nderit" si kadeti më i mirë ndërkombëtar duke u bërë i pari përfaqësues ushtarak nga Ballkani që merr një çmim të tillë në Akademinë Mbretërore Ushtarake "Sandhurst".



Intervistë me nëntogerin e FSK-së, Xhevahir Hasanaj, i cili u shpall kadeti më i mirë në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst të Mbretërisë së Bashkuar

Ky çmim është tejet i rëndësishëm për mua, Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kosovën





Gazeta "Forca Jonë": *Si ju lindi dëshira për t'u bërë kadetë i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së?*

Nëntoger Hasanaj: Qysh kur kamë qenë i vogël kam pasur një dëshirë të madhe t'i shërbej vendit, e pastaj duke u rritur në një vend ku u zhvillua një luftë jashtëzakonisht e madhe, kjo dëshirë sa vinte e rritej edhe më shumë. Kështu si i ri fillova të interesohesha për profesionin e ushtarakut. Në vitin 2010 mësova për shkollimin që ofrohej në Qendrën për Studime Universitare dhe iu përkushtova në tërësi përgatitjeve për t'u regjistruar në këtë shkollë. Shkollimin e fillova në vitin 2011 me një motiv jashtëzakonisht të lartë dhe mjaft i lumtur që ëndrra ime po bëhej realitet.

Gazeta "Forca Jonë": *Cilat ishin sfidat me të cilat u ballafaqove gjatë shkollimit në QSU?*

Nëntoger Hasanaj: Si i ri i ardhur nga bankat e shkollës së mesme, i pa mësuar me rregulla dhe disiplinë, sigurisht se fillimi i një jete ndryshe, me disiplinë të lartë dhe me rregulla rigoroze ushtarake, në fillim ishte sfidë e madhe për mua. Pastaj shumë shpejt, meqë e kisha ëndërr këtë profesion, fillova të përshtatem me këtë jetë. Sfidë po ashtu ka qenë edhe vijimi i studimeve në dy fakultet të ndryshme ushtarake, në QSU dhe në Universitetin Amerikan në Kosovë. Të gjitha këto sfida mund të them se i kam kaluar pa ndonjë vështirësi të madhe, falë dëshirës dhe motivit të lartë për ta bartur uniformën e FSK-së.



Gazeta "Forca Jonë": *Si oficer i FSK-së, për një vit keni studiuar edhe në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst të Anglisë ?*

Nëntoger Hasanaj: Në Angli kam shkuar në mars të vitit 2016. Fillimisht kam ndjekur një kurs përgatitor deri më 8 maj kur edhe kam filluar shkollimin në Sandhurst. Për të vijuar këtë shkollim kam kaluar fazën e përzgjedhjes në Kosovë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, ku kemi konkurruar 11 nëntogerë dhe prej tyre dy jemi përzgjedhur për shkollim në Angli. Në Komisionin Përzgjedhës ka qenë gjeneral Gëzim Hazrolli, një kolonel nga forcat britanike si dhe një kolonel nga ushtria amerikane. Procesi i përzgjedhjes ka qenë plotësisht i njëjtë me procesin e përzgjedhjes së kadetëve anglezë. Akademia ka zgjatur plotë 11 muaj dhe jemi testuar kryesisht në degën e këmbësorisë.

Gazeta "Forca Jonë": *A e keni pritur se do të shpalleni kadeti më i mirë në Akademinë Mbretërore në Angli?*

Nëntoger Hasanaj: Ky çmim është tejet i rëndësishëm si për mua personalisht ashtu edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Është kënaqësi dhe privilegj ta prezantosh vendin dhe të shpërblehesh me çmim të tillë. Nuk mund të them se e kam pritur këtë çmim, për arsye se konkurrenca ishte vërtetë e fortë. Mund të them se që nga fillimi kam shfaqur aftësi të jashtëzakonshme lidershipi, aftësi këto që i kam mësuar në QSU, dhe po ashtu qysh në fillim tregova përgatitje të lartë fizike dhe profesionale, duke dëshmuar kështu se e meritojë një çmim të tillë. Jam testuar jashtëzakonisht shumë në detyra të ndryshme si komandant skuadre, komandant togu, rreshter major kompanie e deri te komandant kompanie. Të gjitha këto detyra i kam kryer me sukses shumë të mirë, duke ja shtuar kësaj edhe rezultatet e larta fizike dhe akademike, më është ndarë çmimi i kadetit me të mirë ndërkombëtar.

Gazeta "Forca Jonë": *Si ishte momenti i pranimit të çmimit nga znj. Thereza May, kryeministre e Mbretërisë së Bashkuar?*

Nëntoger Hasanaj: Ishte më të vërtetë privilegj dhe nder për mua ta marr çmimin personalisht nga një person aq i rëndësishëm i atij vendi siç është Theresa May. Ishte moment krenarie të ecja në atë poligon si kadeti me i mirë ndërkombëtar. Vlen të ceken edhe fjalët e znj. May pas ceremonisë kur mu drejtua personalisht duke me thënë se sa e lumtur ndihet ajo kur sheh forcën tonë në nivel të tillë profesionalizimi. Ajo po ashtu vlerësoi lartë punën që po bëhet në forcën tonë, motivin që kemi për të punuar dhe sakrificat që kjo forcë ka kaluar prej UÇK-së, TMK-së e deri më sot. Znj. May tha se ajo është e gatshme të punojë për së afërmi me Forcën tonë, në një të ardhme të afërt, si aleate e NATO-s.

Gazeta "Forca Jonë": *Sa jeni i gatshëm ta zbatoni në FSK përvojën e fituar në Akademinë e Londrës?*

Nëntoger Hasanaj: Të gjitha njohuritë e fituara në Akademinë e Londrës, tash do t'i zbatojë në forcën tonë së bashku me togun tim dhe njësinë time, në mënyrë që të kemi një forcë profesionale dhe shumë të përgatitur. Qëllimi im kryesor është të përkushtohem maksimalisht në ushtri dhe të zhvilloj një karrierë të gjatë ushtarake, si dhe njohuritë dhe fuqinë time t'i vej në shërbim të profesionalizmit të kësaj force që të na kenë lakmi të gjithë.

Gazeta "Forca Jonë": *Në fund, mesazhi juaj për ushtarët, kadetët dhe nënoficerët e FSK-së?*

Nëntoger Hasanaj: Ushtarët, kadetët dhe nënoficerët e FSK-së të vazhdojnë të punojnë me motivim dhe përkushtim të lartë, sepse vetëm kështu forca jonë do të jetë gjithmonë në nivelin e duhur. Ju jeni më të rëndësishmit dhe më meritoret që sot FSK-ja është forcë profesionale dhe mjaft e përgatitur me suksese të njëpasnjëshme.

Tetari i FSK-së Rafet Gashi fitoi garën ndërkombëtare 'Ushtari më i mirë i vitit 2017' të organizuar nga FSK-ja

Në kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), në një ceremoni u bë shpallja e rezultateve të garës së FSK-së dhe garës ndërkombëtare "Ushtari më i mirë i vitit 2017". Garën ndërkombëtare "Ushtari më i mirë i vitit 2017" e fitoi pjesëtari i FSK-së, tetar Rafet Gashi- pjesëtarë i Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, vendin e dytë ushtaraku nga Kroacia, tetar Ivo Vasiq, ndërsa vendin e tretë po ashtu pjesëtari i FSK-së, ushtar Besnik Nebihu-pjesëtarë i Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së. Gjatë kësaj ceremonie u shpallen edhe rezultatet e garës së FSK-së: ,,Ushtari më i mirë i vitit 2017", ku vendi i parë i takoi tetarit Binak Podrimqaku, vendi i dytë tetarit Elvis Hasanaj dhe vendi i tretë ushtarit Mehdi Bajraktari, që të gjithë pjesëtarë të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së. Të pranishëm gjatë ndarjes së shpërblimeve për të gjithë garuesit si dhe për më të mirët, ishin edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësko-mandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i Departamentit për Operacione dhe Trajnime në MFSK, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, komandanti i Brigadës për Mbështetje Operacionale(BMO), kolonel Avdi Raci, oficerë përfaqësues të vendeve pjesëmarrëse të garës si dhe oficerë e nënoficer të FSK-së. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se, gara e FSK-së për ushtarin më të mirë të vitit tanimë është tradicionale dhe në vazhdimësi është një sfidë me të cilën pjesëtarët e FSK-së janë familjarizuar dhe nëpërmjet saj po tregojnë suksese si brenda FSK-së ashtu edhe në gara ndërkombëtare. Më tej, komandanti i FSK-së shtoi: "Viti 2017 është viti kur FSK-ja ka krijuar mundësitë që një garë e tillë të jetë garë me pjesëmarrje edhe të ushtarakëve nga shtetet e ndryshme, e që për FSK-në do të thotë shumë. Këtë vit garën ,,Ushtari më i mirë" e bën edhe më të veçantë pjesëmarrja e ushtarëve nga 7 shtete partnere, duke e shndërruar kështu në garë ndërkombëtare ushtarake." Në fund të fjalës së tij, gjeneral Rama tha se, FSK-ja çdo ditë po dëshmon se është forcë profesionale e disiplinuar, e motivuar dhe e gatshme të jetë pjesë e shteteve kontribuuese të sigurisë në rajon e më gjerë. Ndërkaq, rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj, gjatë fjalës së tij të mbajtur me këtë rast tha se, gara për ushtarin e vitit ka qenë një mundësi e shkëlqyeshme që ushtarët tanë të shkëmbejnë përvojat dhe shkathtësitë ushtarake me kolegët e tyre nga vendet pjesëmarrëse, dhe më e rëndësishmja, shtoi rreshter majori i parë Metaj, nga ky aktivitet është se janë krijuar ura bashkëpunimi dhe lidhje miqësore në mes pjesëtarëve, pjesëmarrës në garë. "Aktivitetet si kjo garë janë mënyrë shumë e mirë për të rritur ndërveprimin, gatishmërinë fizike, efikasitetin, motivimin dhe në përgjithësi zhvillimin e ushtarëve dhe nënoficerëve, por edhe saktësinë në disa fusha të rëndësishme", shtoi ai. Theksojmë se gara "Ushtarit më i mirë i vitit 2017" filloi më 24 prill dhe vazhdoi deri më 27 prill, ku ushtarët dhe nënoficerët nga të gjitha njësitë e FSK-së dhe nga vendet partnere pjesëmarrëse garuan se bashku dhe treguan përkushtim dhe profesionalizëm të lartë gjatë ekzekutimit të të gjitha detyrave të parashtruara. Në këtë garë morën pjesë 21 garues nga FSK-ja , të cilit garuan për ushtarin më të mirë të FSK-së, dhe 16 garues të cilët garuan për ushtarin më të mirë ndërkombëtar. Përveç Kosovës pjesë e garës ndërkombëtare ishin edhe Shqipëria, Belgjika, Kanadaja, Kroacia, Maqedonia, Turqia dhe Britania e Madhe, të cilat garuan me nga dy pjesëtarë. Gara u zhvillua në këto disiplina: Test fizik, gjuajtje me armë, navigim tokësor, poligon me pengesa, hedhje e granatës, kalimi i zonës së rrezikshme, ndihmë e parë, vëzhgim i terrenit, marshim i shpejtë me ngarkesë dhe testi me shkrim i njohurive ushtarake (test me shkrim ishte vetëm për garuesit e FSK-së).





Forca e Sigurisë, Policia e Kosovës dhe KFOR-i realizua ushtrimin e përbashkët 'Shpata e argjendtë 2017-1'

Në kazermën "Evropianët e Rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Bardh të Vogël dhe në Kampin "Vrellë" në Sllatinë u zhvilluan operacionet e ushtrimit fushor "Shpata e argjendtë 2017-1 (Silver Sabre), i cili u realizua nën udhëheqjen e KFOR-it në bashkëpunim me njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Policisë së Kosovës (PK) dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (EMA). Për ta përcjellë nga afër ushtrimin, që demonstruan këto institucione, të pranishëm ishin edhe drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral brigade Zymer Halimi, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi, ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Rainer, si dhe eprorë të FSK-së, KFOR-it dhe Policisë së Kosovës. Me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua gjeneral Hazrolli, i cili tha se me këtë ushtrim po testohen kapacitetet operacionale dhe bashkëpunimi mes KFOR-it, FSK-së dhe Policisë së Kosovës. "Falënderoi KFOR-in, për mundësinë që na ka ofruar që institucionet e Kosovës, e sidomos FSK-ja të stërvitet për të treten herë më radhë, së bashku me njësitë operacionale të KFOR-it, të cilat veprojnë në Kosovë. "Shpata e argjendtë" është një ushtrim në të cilin janë testuar kapacitetet operacionale, si dhe koordinimi dhe bashkëpunimi me të gjitha institucionet dhe autoritete vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë siç janë KFOR-i, FSK-ja, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhim të Emergjencave". I kënaqur me bashkëpunimin gjatë realizimit të këtij ushtrimi u shpreh edhe zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral Rainer, i cili ndër të tjera shtoi: "Ushtrimet e përbashkëta janë një mundësi unike për të bashkuar të gjithë aktorët dhe organizatat relevante, të cilat janë përgjegjëse për krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt në Kosovë, në përputhje me mandatin dhe misionin e tyre. KFOR-i ka partneritet afatgjatë pothuajse me të gjitha organizatat ndërkombëtare, këtë më se mirë e dëshmon edhe prania e EULEX-it sot këtu. Kjo është pjesë e qasjes gjithëpërfshirëse të NATO-s dhe KFOR-it, përmes implementimit të energjisë dhe shkëmbimit të informacionit". Gjatë këtij ushtrimi i cili ka filluar më 7 prill dhe ka përfunduar më 13 prill, pjesëtarët të cilët ishin të angazhuar patën mundësinë që përmes ushtrimeve dhe skenarëve të ndryshëm të demonstrojnë profesionalizmin dhe forcën e tyre.





FSK-ja dhe KFOR-i demoluan mjete të pashpërthyera në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Deminimit

Sot, (4.4.2017) në Poligonin e KFOR-it, në Zatriq të Rahovecit, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Deminimit, u organizua një operacion për deminimin -shkatërrimin e mjeteve të pashpërthyera, i cili u realizua nga FSK-ja, KFOR-i, Policia e Kosovës dhe nga disa organizata joqeveritare. Në shënimin e kësaj dite ishin të pranishëm zëvendësministri i FSK-së, z. Muhamet Latifi, gjeneral brigade Zymer Halimi Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve, zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, Ahmet Sallova-shef i Qendrës Koordinuese të Deminimit, si dhe përfaqësues të KFOR-it, Policisë së Kosovës, KFOR-i amerikan-Bonstill dhe organizatat joqeveritare që veprojnë në Kosovë. Pas prezantimit të pajisjeve dhe aktivitetit të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, KFOR-it, Policisë së Kosovës si dhe të organizatave joqeveritare, u mbajt edhe një takim i shkurtër me përfaqësues të mediave. Me këtë rast, zëvendësministri i MFSK-së, z. Muhamet Latifi tha: "Kemi ardhur këtu për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Deminimit dhe për të përcjellë nga afër përgatitjen profesionale dhe kapacitetet operacionale të pjesëtarëve të FSK-së." Ne si Ministri duke e vlerësuar si shumë të rëndësishëm pastrimi i zonave të minuara, i kemi kushtuar rëndësi të madhe aftësimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët po japin kontribut të shkëlqyeshëm në këtë aspekt. Këtu ka ndodhur një luftë e cila ka lënë pasoja shumë të mëdha, ku janë minuar shumë fusha. Pastrimi i këtyre fushave është shumë më rëndësi për ne, sepse përveç se siguron jetën e qytetarëve dhe lëvizjen e tyre të lirë, ndikon edhe në zhvillimin ekonomik, për arsye se shumë prona deri më tani nuk kanë pasur mundësi të shfrytëzohen nga qytetarët". Zëvendësministri Muhamet Latifi theksoi se Kompania e Deminimit, deri më tani ka pastruar nga minat mbi 50 milionë metra katrorë si dhe janë gjetur dhe shkatërruar 88,778 mina dhe mjete tjera të pashpërthyera, me këto kapacitete FSK-ja do të vazhdojë pastrimin e të gjitha pjesëve të minuara të Kosovës. Në emër të Ministrisë, z. Latifi ka falënderuar KFOR-in amerikan, gjerman, zviceran, si dhe SHBA-të për ndihmën që ata kanë ofruar qoftë në pajisje të shumta, qoftë në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të Kompanisë së Deminimit. Ndërsa, shefi i Qendrës Koordinuese të Ministrisë së FSK-së, Ahmet Sallova pasqyroi aktivitetet e përgjithshme të Kompanisë së Deminimit të FSK-së. Ai shtoi se, FSK-ja që nga viti 2010 ka pastruar mbi 1.745,465 metra katrorë si dhe ka shkatërruar 2177 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera, kurse ekipet e EOD-së kanë intervenuar në 2136 raste dhe kanë demoluar 3150 mjete të ndryshme eksplozive. Në fund z. Sallova tha se përkundër kësaj pune të madhe të njësive të deminimit deri më tash, janë ende edhe 111 zona të afektuar nga minat dhe mjetet tjera eksplozive të pashpërthyera. Ai falënderoi Njësitet e deminimit të FSK-së dhe organizatat tjera të përfshira në çminimin e mjeteve të pashpërthyera, të cilat kanë krijuar një mjedis të sigurt në këto fushat që tashmë mundësojnë zhvillimin e jetës normale.





Brigada për Reagim të Shpejtë e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka mbajtur trajnimin "Taktika me njësi të vogla"

Brigada e Reagimit të Shpejtë e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Istog, është duke realizuar njërin nga trajnimet me sfidues "Taktikat për njësi të vogla". Për të përcjellë nga afër realizimin e këtij trajnimi dhe disa aktivitete të vazhdueshme të BRSH-së, më 25 prill 2017, ishin të pranishëm edhe ushtruesi i detyrës së komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci dhe shefi i Shtabit të BRSH-së, nënkolonel Ejup Maqedonci. Me këtë rast kolonel Geci i përgëzoi pjesëmarrësit e këtij trajnimi për angazhimin dhe përkushtimin e treguar deri më tani dhe kërkoi nga ta që të vazhdojnë të angazhohen maksimalisht, sepse ky trajnim është esencial për formësimin dhe profesionalizimin e karrierës së një ushtaraku. Në trajnimin "Taktikat për njësi të vogla" i cili deri më tani është realizuar nga instruktorët e ushtrisë amerikane, tanimë realizohet nga instruktorët e BRSH-së, ku numri më i madh i pjesëmarrësve në këtë trajnim janë femra dhe kanë mundësi që të trajnohen në disa disiplina: Aftësimi i pjesëtarëve në udhëheqje dhe operim me ekipe dhe skuadra, patrulla, rikonicion, repilim, navigim tokësor ditën dhe natën, prita, reagimi në kontakt, qitje taktike dhe stresuese me armë, operacione urbane si dhe në disiplina tjera të rëndësisë së veçantë për FSK-në. Përveç këtij trajnimi, Brigada e Reagimit të Shpejtë në bazë të planit kalendarik për vitin 2017, është duke realizuar një mori aktivitetesh të rëndësishme për zhvillimin profesional të pjesëtarëve të saj. Gjatë kësaj periudhe në batalionet e BRSH-së është duke u realizuar faza 4- mujore trajnuese në kuadër të Gjenerimit të Forcës, kurse në Komandën e BRSH-së janë realizuar dy seminare të rëndësishme; ,,Trajnimi për Lidership" dhe ,,Procesi i



Vendimmarrjes Ushtarake". Njëra nga prioritet e BRSH-së është edhe përgatitja e pjesëtarëve për aktivitetin "Shqiponja Patrulluese", i cili do të zhvillohet në FSK.
Aktivitetet që ka realizuar dhe po realizon Brigada e Reagimit të Shpejtë kanë ngritur nivelin e përgatitjes profesionale te pjesëtarët e BRSH-së në të gjitha fushat, përkundër që këto aktivitete, kryesisht të nivelit taktik, janë mjaft sfiduese, gatishmëria, vullneti dhe dëshira e pjesëtareve të BRSH-së për trajnim si dhe mbështetja e pakursyer e lidershipit të BRSH-së në çdo kohë shihet në të gjitha njësitë. Falë kësaj, tani këta pjesëtarë posedojnë përgatitje të lartë fizike dhe taktike dhe janë të gatshëm të përballen me të gjitha detyrat që mund t'iu caktohen.

Oda Zejtare e Dortmundit dhe Oda Ekonomike Kosovës ndihmojnë pjesëtarët e FSK-së

Dje (7 prill 2017) u certifikuan dy pjesëtarë të FSK-së, të cilët për 17 muaj ndoqën një trajnim profesional në fushën e automekanikes. Trajnim u zhvillua nga Oda Zejtare e Dortmundit e mbështetur nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim e Gjermanisë dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerët kosovarë, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Shkolla Profesionale "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë. Trajnimi ka filluar qysh në nëntor të vitit 2015 dhe ka përfunduar më 31 mars të vitit 2017. Ky trajnim/arsimim profesional me elemente të praktikës duale, shkollë-ndërmarrje, është zhvilluar në fushën e automekanikes për mirëmbajtje të mjeteve të motorizuara dhe sipas standardeve gjermane të arsimit profesional. Në ceremoninë përmbyllëse të këtij trajnimi morën pjesë përfaqësues të OZD-së, OEK-së, FSK-së, KFOR-it dhe përfaqësues të shkollës. Provimi praktik dhe teorik është mbajtur



nën mbikëqyrjen e ekspertëve nga OZD-ja, përfaqësuesit e KFOR-it gjerman dhe mësimdhënësit e automekanikes nga shkolla "Shtjefën Gjeçovi\". Me këtë rast, z. Wilhelm Hicking, drejtori gjeneral i Odës Zejtare të Dortmundit tha se; ne besojmë shumë që bashkëpunimi me FSK-në do të vazhdojë edhe në të ardhmen në fusha me interes të përbashkët, bazuar edhe në arritjen e rezultateve të shkëlqyeshme të dy pjesëtarëve të FSK-së, Lavdim Bajraktarit dhe Agron Abdullahut. Në këtë drejtim kontribut të madh ka dhënë edhe Shkolla Profesionale "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë, e cila nga Oda Zejtare e Dortmundit është pajisur me aparaturën dhe sistemin më modern në rajon. Pjesëtarëve të FSK-së, të cilët morë pjesë në këtë trajnim, iu ndanë certifikata nga Wilhelm Hicking, drejtori gjeneral i OZD-së, Ferat Idrizi, drejtor i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Aftësim për të Rritur në Kosovë dhe Parim Bajrami, sekretar i OEK-së. Gjithashtu, një kontribut të veçantë në trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së kanë dhënë edhe ndërmarrjet: "Auto Kaçandolli LLC\"në Prishtinë, "AHP LLC" në Prizren dhe "Baki Automobile - Volkswagen"në Llapnasellë.
Bashkëpunimi në mes OZD-së, OEK-së dhe FSK-së, do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të realizimit të projekteve në fushat më interes të përbashkët dhe posaçërisht në të mirë të pjesëtarëve të FSK-së, tha z. Franc Musolli, përfaqësues i OZD-it dhe koordinator i projekteve të Partneritetit për Arsim Profesional dhe Akademi të Ndërmarrësisë në Kosovë.

FSK-ja me aktivitete të shumta shënoi Ditën Ndërkombëtare të Tokës

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK) dhe FSK-ja, në koordinim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më 22 prill 2017, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës, organizuan aktivitete të shumta në pastrimin e ambientit, mbjelljen e fidanëve-drurëve dekorativ dhe luleve në shumë qytete të Kosovës. Aksioni për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës u shënua edhe në të gjitha kazermat e FSK-së. Kurse aktiviteti kryesor u mbajt në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, ku pjesëtarët e FSK-së, u dalluan me pastrimin e ambientit të kazermës si dhe me mbjelljen e fidanëve të drurëve dekorativ, pishave dhe të luleve. Gjithashtu në kuadër të këtij bashkëpunimi; FSK-ja ka qenë e angazhuar me mjetet teknike dhe personel në mbështetje të MMPH-së, me kamionë dhe ekskavator, në shumë qytete të Kosovës si: në Prishtinë, Ferizaj, Istog, Fushë Kosovë, etj.
Në emër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përshëndeti ministri Ferat Shala, i cili i dha mirënjohje FSK-së, për mbështetjen e MMHP-së.
Koordinatori për të gjitha aktivitetet në mes MFSK/KFT-së dhe MMPH-së, nënkolonel Afrim Veseli - Departamenti i BCU-së, të MFSK-së, u shpreh tejet falënderues për bashkëpunimin si dhe për realizimin e aktiviteteve të përgjithshme të FSK-së, jo vetëm në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës, por edhe në afrimin e ndihmës së qytetarëve me mjete logjistike në shumë qytete të Kosovës.



Orkestra e Ushtrisë turke dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës zhvilluan koncert të përbashkët



Në Kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, (21.04.2017) u mbajt një koncert i përbashkët i Orkestrës Muzikore të Forcave të Armatosura të Turqisë në bashkëpunim me Orkestrën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Për të dëgjuar programin e dy orkestrave të pranishëm ishin zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendës komandanti komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO), kolonel Avdi Rraci, shefi i Operativës së KFT-së, kolonel Bashkim Shillova, komandanti i Kontingjentit Turk në Kosovë, kolonel MustafaTavazar si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë. Me këtë rast të gjithë të pranishmëve me një fjalë rasti i'u drejtua gjeneral Hazrolli i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit, ndërsa Orkestrën e Ushtrisë turke e falënderoi për këtë iniciative dhe bashkëpunim, dhe shtoi se: "në kuadër të ndërtimit të kapaciteteve operacionale një ndër kapacitetet shumë të rëndësishme është edhe Bendi Muzikor". Në fund gjeneral Hazrolli tha gjithashtu se: ,,Ne mburremi me kapacitetet që kemi ngritur deri tani dhe me profesionalizmin e tyre dhe mendoj që shkëmbimi i eksperiencave me Orkestrën Muzikor të ushtrisë turke do të jetë edhe një e arritur pa diskutim që do të shohim edhe në të ardhmen". I kënaqur nga realizimi i këtij bashkëpunimi u shpreh edhe komandanti i Kontingjentit ushtarak turk në Kosovë, kolonel Mustafa Tavazar " Bendi muzikor i ushtrisë së Turqisë së bashku me Orkestrën Frymore të FSK-së na bënë që të përjetojmë qaste të këndshme, jemi mjaft të kënaqur edhe me bendin që ka FSK-ja". Në fund, kolonel Tvazar Na u shpreh se FSK-ja ka një bend të mrekullueshëm: ,,Qëllimi ynë është të tregojmë respektin që kemi ndaj Kosovës edhe nëpërmjet shkëmbimeve kulturore". Gjatë këtij koncerti të gjithë të pranishmit patën mundësi që të argëtohen dhe të shijojnë interpretimin e veprave të mrekullueshme nga këto dy orkestra me ç 'rast Orkestra turke befasoj publikun me interpretimin e dy këngëve shqipe të cilat u priten mjaft mirë nga të gjithë të pranishmit.

U mbajte gara humanitare në atletikë "Vrapo me FSK-në - Mitrovica 2017"



Të dielën (11.04.2017) në qytetin e Mitrovicës, Forca e Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me Federatën e Atletikes së Kosovës dhe Komunës së Mitrovicës realizuan garën humanitare në atletikë "Vrapo me FSK-në-Mitrovica 2017" i realizuar nga oficerët e rinj të Forcës së Sigurisë të Kosovës, me q'rast të gjitha fondet e mbledhura, do të shkojnë për familjet në nevojë të kësaj komune. Për ta nderuar dhe përcjellë nga afër këtë ceremoni të pranishëm ishin drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjeneral brigade Zymer Halimi, nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, z. Faruk Mujka, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri, ushtrues detyre i Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH), kolonel Xhevahir Geci, shefi i Operativës së KFT-së, kolonel Bashkim Shillova si dhe eprorë dhe oficerë të MFSK-së dhe FSK-së. Para fillimit të garës të pranishmeve ju drejtua nënkryetari i Mitrovicës Faruk Mujka i cili falënderoi organizatorët për këtë organizim i cili siç tha z.Mujka ,,në vetë ka dy porosi mjaft të rëndësishme që të merremi sa më shumë më aktivitete



sportive dhe të shtrijmë shpirtin e solidaritetit dhe humanizmit dhe ju uroj suksese gjithë pjesëmarrësve në këtë garë". Në vrapimin 10 km, morën pjesë pjesëtarë të FSK-së, KFOR-it, shoqërive joqeveritare, qytetarë të Kosovës i'u bashkua edhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell së bashku me bashkëshorten e tij. Të gjithë garuesit arritën që ta përfundojnë me sukses këtë vrap ndërsa tri vendet e para në kategorinë e meshkujve takuan: vendi i parë (medalje e artë) Emin Grajqevci, më nr. 770, vendi i dytë (medalje e argjendtë), Tiron Mamusha, nr. 644 dhe vendi i tretë(medalje të bronztë) Bujar Uka, me nr 788. Në kategorinë e femrave vendin e parë (medaljen e artë) e fitoi Qëndresë Ramadani, me nr 865, vendi i dytë (medalje argjendtë) Nebahate Maqastena, me nr. 646 dhe vendi i tretë (medalja e bronztë) i takoi oficerit të FSK-së, toger Manushaqe Nura, me nr. 652. Në fund, tri vendeve të para u dhuruan Medalje nga eprorët e FSK-së dhe nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, ndërsa gjithë pjesëmarrësit u shpërblyen me Certifikatën e pjesëmarrjes. Vrapi Humanitar "Vrapo me FSK" është një aktivitet i iniciuar dhe organizuar nga oficerët e rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës, me qëllim të promovimit të shëndetit të mirë përmes aktivitetit sportiv, por mbi të gjitha ka vlera humane. Edhe kësaj radhe FSK-ja dëshmori se është afër qytetarëve të saj, edhe në të ardhmen do të jetë afër tyre, për t'i ndihmuar të gjithë ata që kanë nevojë.

FORCA JONË

* * * Viti VI • Nr. 58 • Qershor 2017 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Ministri i FSK-së Haki Demolli u prit nga ministri i Mbrojtjes së Turqisë Fikri Isik

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli, (12 maj 2017) zhvilloi një takim në Stamboll me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, zotëri Fikri Isik, gjatë qëndrimit të tij në panairin e 13-të Ndërkombëtar të Mbrojtjes (IDEF 2017), në Turqi. Në takimin e përbashkët, ministri Demolli dhe ministri i Mbrojtjes të Turqisë, zotëri Isik, folën për marrëdhëniet e mira ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë si dhe për bashkëpunimin dhe koordinimin e shkëlqyeshëm ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë në përgjithësi. Ministri Demolli e falënderoi në veçanti ministrin Isik, për mbështetjen e vazhdueshme që Ministria turke e Mbrojtjes po jep për FSK-në, si në fushën e arsimimit; me anë të programeve të ndryshme për shkollimin dhe trajnimin e kuadrove ushtarake dhe civile, ashtu edhe në mbështetjen me donacione dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore për trajtimin e pjesëtarëve të FSK-së, në Qendrën Spitalore të Ushtrisë së Republikës së Turqisë. Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, zotëri Fikri Isik shprehu gatishmërinë e Turqisë për ta vazhduar bashkëpunimin e plotë dhe të përkushtuar për Kosovën, me theks të veçantë për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së si institucion për të cilin populli i Kosovës ka investuar shumë. Në takim, Ministri shoqërohej nga këshilltari ushtarak i tij, kolonel Fadil Hadergjonaj si dhe atasheu i FSK-së në Ankara, nënkolonel Bekim Osmani.



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim anëtarin e Kongresit amerikan z. Steve King

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim, në Ministrinë e FSK-së, anëtarin e Kongresit të SHBA-ve, republikanin nga Ajova, zotëri Steve King. Në takimin e përbashkët të gjeneral Ramës dhe kongresistit King u bisedua për marrëdhëniet e mira ndërmjet SHBA-ve dhe Kosovës, bashkëpunimin e mirë ndërshtetëror në mes të Kosovës dhe Ajovës dhe në veçanti për bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Ushtrisë amerikane në përgjithësi. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, e njoftoi kongresistin King



për zhvillimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe për progresin e saj në aspektin e ndërveprueshmerisë me të gjithë partnerët, sipas standardeve të NATO-s. Gjithashtu, gjeneral Rama e njoftoi anëtarin e Kongresit Steve King edhe mbi planet strategjike për zhvillimin e Forcës së Kosovës, konkretisht mbi synimin e shtetit të Kosovës që FSK-ja të transformohet në Forcë të Armatosur, me mision dhe detyra të mbrojtjes së vendit. Gjeneral Rama e siguroi kongresistin King se FSK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet, është plotësisht e gatshme për transformim, dhe pret vendimmarrjen politike të institucioneve më të larta të shtetit. Gjithashtu, gjeneral Rama ritheksoi qe i gjithë procesi i transformimi do të jetë transparent dhe në koordinim me partnerët strategjikë të Republikës së Kosovës. Nga ana e tij, kongresisti amerikan Steve King shprehu gatishmërinë e SHBA-ve për ta vazhduar bashkëpunimin e plotë dhe të përkushtuar për Kosovën, me theks të veçantë për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së, si institucion për të cilin populli i Kosovës ka investuar shumë. Gjithashtu, kongresisti King shprehu përkushtimin për të lobuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Ajovës dhe Kosovës në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Kapiteni i FSK-së shpallet oficeri më i mirë ndërkombëtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK-së), kapiten Mentor Ibrahimi, pjesëtar i Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, u shpall oficeri më i mirë ndërkombëtar në kursin "Kapiten Karriere" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mentor Ibrahimi që nga shtatori i vitit 2016 e deri më 18 maj 2017, ka marrë pjesë në kursin "Kapiten Karriere" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjenerata 17-1, dhe prej të gjithë oficerëve pjesëmarrës, nga shtete të ndryshme, u shpall më i miri. Kapiteni Mentor Ibrahimi gjatë shkollimit të tij, në Kursin e Karrierës për Kapiten të Këmbësorisë në Qendrën e Ekselencës (Maneuver Center of Excellence) në Fort Benning të SHBA-ve, ka shfaqur performancë të jashtëzakonshme në fushat, si:



Procesi i Vendimmarrjes Ushtarake, Terminologjia dhe Grafika Ushtarake dhe në Doktrinën Amerikane në përgjithësi. Ndërkaq, pas përfundimit të kursit "Kapiten Karriere", kapiteni Mentor Ibrahimi shpallet studenti më i mirë ndërkombëtar, me ç 'rast nga komandanti i kursit gjeneral major Eric Wesley, si shenjë mirënjohjeje për arritje të jashtëzakonshme, i dhurohet libri me përmbajtje ushtarake "Fjalë për luftëtarët".

Tetari i FSK-së, Binak Podrimçaku shpallet ushtari më i mirë në Garën Ndërkombëtare në Kroaci

Në Garën Ushtarake Ndërkombëtare, që u zhvillua në Knin të Kroacisë, nga data 18-19 maj 2017, pjesëtari i Forcës së Sigurisë të Kosovës, tetari Binak Podrimçaku u shpallë ushtari më i mirë i garës. FSK-në në Garën Ushtarake Ndërkombëtare e përfaqësuan dy pjesëtarë, tetarët: Binak Podrimçaku dhe Liridon Selimi. Gara ushtarake e zhvilluar në Kroaci është njëra ndër garat më të forta në botë, e ku morën pjesë mbi 150 pjesëmarrës nga vendet e NATO-s dhe vendet partnere për zgjedhjen e ushtarit më të mirë ndërkombëtar. Garuesit në ditën e parë u testuan në gjuajtje me armë të ndryshme, dhe në ditën kryesore; marshuan 35 kilometra me ngarkesë 15.2 kg dhe ekzekutuan 12 detyra ushtarake. Në renditjen e përgjithshme të Garës Ushtarake Ndërkombëtare për vitin 2017,



Kosova zuri vendin e parë, vendin e dytë e zuri Austria, ndërsa vendin e tretë Shqipëria. Ky është suksesi i radhës i FSK-së, që po dëshmon profesionalizmin dhe standardet e larta të ushtarëve të FSK-së.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama priti zyrtarin e lartë të NATO-s z. Michel Soula

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur sot, (11 maj 2017) në një takim zyrtar një delegacion të NATO-s, të kryesuar nga z. Michel Soula, udhëheqës i Sektorit për Operacione në Komitetin Ndërkombëtar të NATO-s, i cili shoqërohej nga gjeneral brigade Dietmar Mosmann, drejtor i NALT-it (Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s), oficerë dhe zyrtarë të lartë të NALT-it. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, duke e falënderuar delegacionin e NATO-s për vizitën, i ka njoftuar ata gjerësisht me zhvillimet e përgjithshme në FSK. Me këtë rast, ai u fokusua te procesi dhe procedurat e deritashme të përgatitjeve për transformimin e



FSK-së, duke vlerësuar se Ministria dhe FSK kanë kryer bazën ligjore dhe fazat e planifikimit të detajuar për përfundimin me sukses të këtij procesi. Po ashtu komandanti i FSK-së e njoftoi mysafirin e lartë nga Brukseli me mbajtjen e sukssesshme të konferencës "FSK dhe Partnerët", ku janë trajtuar arritjet e deritashme në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe fushat ku duhet thelluar ky bashkëpunim me partnerët, në bazë të nevojave që ka FSK-ja. Në takim ai foli edhe për publikimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Pakicë, e cila është bërë në prani të partnerëve ndërkombëtarë, shoqërisë civile dhe mediave. Në vazhdim të fjalës së tij, ai tha se kjo strategji nuk ka ngelë vetëm projekt, por janë bërë edhe aktivitete konkrete për realizimin e saj për çka ne si FSK dhe ministri jemi të kënaqur me rezultatet e arritura. Ndërsa në fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm, z. Shkëlzen Sylaj, ndër të tjera e njoftoi mysafirin për projektin për realizimin e planit të integritetit, që është duke u bërë në bashkëpunim me shtetin e Norvegjisë, duke theksuar se ky është i pari plan i integritetit që po bëhet në institucionet shtetërore të Kosovës, duke shpresuar që do jetë model edhe për ministrit tjera. Nga ana e tij z. Michel Soula u shpreh i kënaqur me aktivitet e deritashme të ndërmarra nga ministria dhe FSK, si për përgatitjet që janë bërë për transformimin e FSK-së në FAK, dhe për qasjen e hapur dhe bashkëpunuese që ka pasur ndaj kësaj çështje. Ai po ashtu vlerësoi lartë edhe angazhimet konkrete për inkuadrimin e komuniteteve pakicë në FSK, duke u angazhuar se komunikimi dhe bashkëpunimi në mes NATO-s dhe FSK-së do të jetë i vazhdueshëm për të gjitha çështjet. Në takim ishte i pranishëm edhe Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë Politike të MFSK-së.

Ministri Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në Panairin Ndërkombëtar të Mbrojtjes në Stamboll

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarin e Përgjithshëm të MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj dhe një delegacion i lartë i FSK-së, nga data; 09-12 maj 2017, morën pjesë në "Panairin e 13-të Ndërkombëtar të Mbrojtjes IDEF 2017" në Stamboll të Turqisë. Gjatë vizitës, delegacioni i FSK-së, ka zhvilluar takime të rëndësishme dypalëshe me pjesëmarrës të panairit nga ministritë e mbrojtjes të shteteve të ndryshme. Po ashtu takime të nivelit të lartë janë mbajtur edhe me zyrtarë dhe oficerë të lartë të ushtrisë së Turqisë. Në këto takime temë e bisedimeve ka qenë rritja dhe thellimi i bashkëpunimit edhe në të ardhmen në fushat me interes të përbashkët. Gjatë qëndrimit në panairin ndërkombëtar, delegacioni i FSK-së, ka vizituar prodhimet e ekspozuara të shumë kompanive ndërkombëtare, që po marrin pjesë në këtë panair, me pajisjet dhe teknikën e tyre ushtarake. Pjesë e delegacionit të MFSK/FSK-së, ishin edhe drejtori i Operativës dhe Trajnimeve gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, këshilltari ushtarak i ministrit kolonel Fadil Hadergjonaj, atasheu ushtarak i FSK-së, në Ankara, nënkolonel Bekim Osmani, kapiten Jaser Mulla, Florin Hoxha, sekretar i sekretarit të Përgjithshëm dhe Latif Leka, shef i kabinetit të Ministrit të MFSK-së.



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe SP z. Shkëlzen Sylaj pritën ambasadorin e Kanadasë



Sot, (24 maj 2017) në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me sekretarin e përgjithshëm të MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, priten në takim ambasadorin e Kanadasë, për Kroaci dhe Kosovë, z. Daniel Maksymiuk. Në këtë takim, KOMFSK dhe Sekretari i Përgjithshëm e njoftuan ambasadorin me të arriturat e përgjithshme të MFSK/FSK-së si dhe me proceset dhe rrugën për të ardhmen e FSK-së. Ambasadori i Kanadasë, z. Maksymiuk edhe njëherë konfirmoi gatishmërinë e shtetit të tij, për përkrahje të pa rezervë për MFSK/FSK-në dhe shtetin e Kosovës në përgjithësi. Me këtë rast, ambasadori i Kanadasë shprehu gatishmërinë dhe kërkoi inicimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me MFSK/FSK-në, për zhvillimin e aktiviteteve konkrete në fushën e trajnimit dhe avancimit të pjesëtarëve të FSK-së. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjithashtu konfirmoi që edhe MFSK/FSK-ja, janë të gatshëm për nënshkrim të një marrëveshje të tillë e cila hapë rrugë të reja për ngritjen profesionale te të gjithë pjesëtarëve të MFSK/FSK-së.

Sekretari i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj mori pjesë në takimin e CIDS-it në Vjenë të Austrisë

Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj së bashku me asistentin e tij personal, z. Florin Hoxha me ftesë të CIDS (Center for Integrity in Defence Sector / Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes) nga data 25 deri më 27 maj 2017, qëndruan në Vjenë të Austrisë, për të marrë pjesë në takimin e përbashkët me përfaqësues të CIDS-it dhe ekspertë rajonalë të CIDS- it. Në këtë takim z. Damir Ahmetovic- ekspert rajonal i CIDS-it dhe z. Florian Qehaja- udhëheqës i ekipit të CIDS për Kosovë, në prani të Knut Walbækken/ CIDS Oslo dhe Svein Eriksen/ CIDS Senior Advisor, prezantuan raportin e implementimit të projekteve për periudhën trevjeçare: Menaxhimi i Resurseve Njerëzore dhe Ngritja e Integritetit në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK). Gjatë takimit sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z.Sylaj falënderoi Qeverinë norvegjeze për përkrahjen e vazhdueshme që i ofron MFSK-së, në veçanti me dy projektet shumë të rëndësishme për MFSK-në. Me këtë rast, sekretari i përgjithshëm shfrytëzoi rastin që me qëllim të thellimit të bashkëpunimit të kërkojë nga përfaqësues të CIDS-it, që gjatë periudhës së ardhshme të nënshkruajë Marrëveshje Bashkëpunimi me MM të Norvegjisë. Po ashtu në këtë takim sekretari i përgjithshëm para përfaqësuesve të CIDS, shfrytëzoi rastin që të paraqesë propozimet e tij dhe arsyetimin për vazhdimin e përkrahjes edhe për periudhën e ardhshme trevjeçare.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Në Ministrinë për FSK u hap zyra e përhershme për Bashkëpunim të Mbrojtjes e Ambasadës Amerikane

Që nga sot, (5 maj 2017) në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), do të jetë e hapur zyra e përhershme e Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes (Office for Defense Cooperation - ODC), e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të funksionoj, tani e tutje, në baza ditore. Në ceremoninë e hapjes së zyrës së ODC-së, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ishin të pranishëm: ministri i FSK-së, Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, atasheu i Mbrojtjes të SHBA-vë, kolonel Jefry Fisher, oficerët e lartë të FSK-së: gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, përfaqësues të Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes të SHBA-ve, oficerë të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK-në, si dhe oficerë e zyrtarë të MFSK-së dhe FSK-së. Hapjen zyrtare të Zyrës së ODC-së në MFSK e bëri ministri Haki Demolli i cili e vlerësoi këtë akt, si moment mjaft të rëndësishëm, sepse tani e tutje praktikisht, bashkëpunimin e suksesshëm të do ta realizojmë duke qenë më afër dhe në kontakt në baza ditore. Më tutje, Ministri Demolli, në emrin e tij, të Komandantit të FSK-së dhe gjithë stafit të Ministrisë dhe Forcës u shpreh, se personeli i Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes të SHBA-ve, do të kenë përkrahjen dhe mbështetjen e gjithanshme gjatë shërbimit të tyre në ambientet tona. Nga ana e tij, shefi i ODC-SHBA, major Brian Devlin tha se kjo zyrë do të kontribuojë edhe më shumë në thellimin e bashkëpunimit në mes të MFSK/FSK dhe Ushtrisë së SHBA-ve. Zyra për Bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes është strukturë përgjegjëse për bashkëpunim bilateral në fushën e mbrojtjes në mes të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe strukturave ushtarake të Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Komandën Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga shefi i Zyrës për Bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes (US-ODC).



Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës prezantoi Strategjinë për integrimin e komuniteteve

Sot (4 maj 2017) në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) u bë prezantimi dhe diskutimi i Strategjisë për integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Referenca për hartimin e Strategjisë ishin: Deklarata e Ministrit të FSK-së për Politikën e Komuniteteve Etnike e datës 12.10. 2016, si dhe vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm të MFSK-së (grupi punues) për hartimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve etnike në MFSK/FSK(07.11.2016).Në këtë takim morën pjesë, ministri Haki Demolli, zv.ministri Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Zymer Halimi dhe Nazmi Brahimaj, ambasadorë dhe përfaqësues të ambasadave, pjesëtarë të Ekipit Këshillues të NATO-s për MFSK/FSK, përfaqësues të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së etj. Fillimisht, ministri Haki Demolli ri-konfirmoi vlerësimin dhe gatishmërinë e tij dhe të MFSK-së lidhur me punën e palodhshme që është bërë në planin e integrimit të pjesëtarëve të komuniteteve në FSK. Ai tha: se draftimi, aprovimi dhe implementimi i Strategjisë për integrimin e komuniteteve jo-shumicë tregon përkushtimin e vazhdueshëm të Qeverisë së Kosovës dhe të MFSK-së, si dhe është dëshmi se FSK-ja është e hapur për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh prejardhjen etnike, racore, religjioze apo të kaluarën politike. Në fund, ministri Demolli tha se qëllimi final i MFSK-së është rritja e numrit të pjesëtarëve nga komunitetet jo-shumicë deri në 10 për, me perspektivë në strukturë dhe rangje, si dhe u zotua se: "FSK-ja do të jetë e pranishme me aktivitete edhe më tutje në vendbanimet me komunitetet jo-shumicë, sidomos në ato lokalitete ku komuniteti serb jeton më në shumicë". Ai pos tjerash, tha se FSK-ja ka punuar shumë në drejtim të aplikimit të planifikimeve për integrimin e suksesshëm të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, për të shërbyer për vendin, në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës.



Ndërsa, prezantimin e dokumentit strategjikë për integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve në FSK, në emër të grupit punues e bëri shefja e zyrës së Komuniteteve në MFSK, znj. Azemina Çullum e cila tha se vizioni i Ministrisë për FSK është që të krijojmë dhe të mbajmë një forcë shumë etnike me perspektive të fortë dhe të qëndrueshme.

Kurse komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha:"Ne me veprimin tonë, jemi vërtet model. Fillimisht kemi bërë shumë për me ndërtua besimin, sidomos te komuniteti serb, duke u shprehur i bindur se strategjia për integrimin e komuniteteve do të jetë program, ndërsa gatishmëria për ta zbatuar dhe angazhimi konkret do të jenë detyrë e vazhdueshme e MFSK-së dhe FSK-së.,,FSK ka bërë përpjekje në mënyrë të vazhdueshme për të inkurajuar pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve jo shumicë në Kosovë dhe rekrutimin e tyre në FSK. Pjesëmarrja dhe përfshirja e komunitetit jo shumicë ka qenë sfiduese dhe njëra ndër proceset më të vështira në kuadër të integrimit të tyre në FSK deri më tani, por përkushtimi ynë konkret mbetet, që komunitetet jo-shumicë t'i integrojmë dhe ky integrim të jetë i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm, duke shprehur përkushtimin se mbi bazën e kritereve dhe standardeve që vlejnë për të gjithë, FSK-ja synon që 10 për qindëshin do ta tejkalojë, gjithmonë duke respektuar standardet e rekrutimit", përfundoi fjalën e tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama.

Ndërsa, atasheu i Mbrojtjes pranë ambasadës së SHBA-ve, koloneli Jefry Fisher tha se: "Këtë çka ka bërë FSK-ja, është shembull i mirë edhe për të tjerët". Ai tha se: ,,hapi i ardhshëm sfidues është realizimi i këtij plani dhe unë kam besim në udhëheqjen e mirë të drejtuesve të FSK-së."Strategjia për integrim të komuniteteve jo shumicë përcakton qëllimet dhe politikat që do të zbatohen, përmes integrimit të të gjitha aktiviteteve dhe proceseve, për të siguruar realizimin e objektivave dhe qëndrueshmërinë e integrimit të komuniteteve jo shumicë.

Komandanti i KDS-së, gjenerali Enver Cikaqi vizitë zyrtare në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë të Kosovës gjeneral brigade Enver Cikaqi, me ftesë të komandantit të KDS-së të FA të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Manushaqe Shehu, qëndroi për vizitë tri ditore në Republikën e Shqipërisë, me q 'rast mori pjesë edhe në ceremoninë e përfundimit të Kursit të Lartë të Oficerit. Delegacioni i FSK-së, është pritur nga zëvendës ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Petro Koçi, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Tonin Marku, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani dhe komandanti i KDS-FARSH, gjeneral brigade Manushaqe Shehu. Gjatë takimeve, delegacioni i FSK-së, është njoftuar me operacionet dhe stërvitjet që FARSH janë duke zhvilluar brenda dhe jashtë vendit, si dhe me procesin e modernizimit me armatime dhe pajisje tjera brenda forcës. Gjithashtu u bisedua edhe për bashkëpunimin e deritanishëm të dy institucioneve, si dhe për thellimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Bazuar në përvojën që ka krijuar ushtria shqiptare, por edhe inkuadrimi i saj në strukturat euro-atlantike, është diskutuar



gjatë për mënyrat e bartjes së dokumenteve doktrinarë dhe adaptimit të tyre në forcën tonë. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë mbështetur bibliotekën e KDS-FSK-së me dokumente doktrinarë dhe tituj librash të ndryshëm, dokumente dhe libra të cilat do të shërbejnë si bazë e mirë për përpilimin apo rishikimin e dokumenteve aktuale. Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe delegacioni i FSK-së, gjatë qëndrimit në Shqipëri vizituan edhe oficerët e lartë të FSK-së, të cilët janë duke ndjekur trajnime në shkollat ushtarake të FARSH. Vizita të ndërsjella ka pas edhe në të kaluarën nga komandantët e të dy Komandave si dhe do të ketë edhe në ardhmen me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve, si dhe të njohjes dhe shkëmbimit të përvojave në mes të dy institucioneve (FSK dhe FARSH) u tha gjatë takimeve.

Në BRSH me sukses u realizua gara sfiduese 'UJKU GARUES 2017'



Në Brigadën për Reagim të Shpejtë në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, u realizua gara "Ujku Garues 2017". Kjo garë është realizuar për herë të tretë në nivel të BRSH-së, ku garuesit sfidohen në shkathtësi profesionale dhe fizike. Në garë morën pjesë gjithsejtë 13 ekipe, secili batalion i BRSH-së me nga 3 ekipe, gjithsej 9 ekipe, BMO me tri ekipe dhe KDS-ja me një ekip. Disiplinat në te cilat u sfiduan garuesit ishin këto: Vrapimi 3.2 km, hedhja e granatës së dorës, shtyrja e autoblindës, vëzhgim, kalimi i zonave të minuara dhe kalimi mbi zona të rrezikshme. Synimi kryesor i organizimit të kësaj gare ka qenë që ekipet pjesëmarrëse të sfidoheshin në disiplinat e lartcekura, në mënyrë që të dëshmonin përgatitjen fizike dhe mendore. E gjithashtu, kjo garë është realizuar me qëllim të motivimit të pjesëtarëve për ngritjen e vazhdueshme të shkathtësive profesionale dhe bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet njësive të FSK-së. Ceremonia e certifikimit të garës së shkathtësive ushtarake "Ujku Garues 2017" u realizua sot (29 maj 2017) në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog. Në ceremoni ishin të pranishëm: Gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, KOMBRSH kolonel Xhevahir Geci, zv. KOMBMO kolonel AvdiRaci, rreshter majorja komanduese e Gardës së IOWA-s Reachel Fails, Shtabi i BRSH-së, komandantet e batalioneve, oficerë dhe nënoficerë të BRSH-së dhe njësive tjera të FSK-së. KOMBRSH, kolonel Geci gjatë fjalës së tij drejtuar të pranishmëve shfrytëzoi rastin t'i uronte të gjitha ekipet për sukseset që treguan në këtë garë. Ai veç tjerash tha: "Qëllimi i ynë është që përmes kësaj gare të ngremë nivelin e punës ekipore, shpirtin garues dhe përgatitjen fizike dhe profesionale të pjesëtarëve të njësive tona. Kjo garë ka arritur që jo vetëm të jetë sfiduese, por gjithashtu ka karakter miqësor duke e ngritur edhe më shumë bashkëpunimin ndërmjet njësive të FSK-së, më qëllim që të gjithë së bashku të arrijmë synimet tona madhore. Garat dhe aktivitetet që po zhvillohen brenda FSK-së janë duke ndikuar dukshëm në sukseset dhe rezultatet që në vazhdimësi po tregojnë pjesëtarët e FSK-së në trajnime, në shkolla prestigjioze ushtarake dhe në gara të ndryshme jashtë vendit. Ekipet garuese të FSK-së treguan përkushtim dhe disiplinë maksimale, duke bërë që kjo garë të bëhet edhe më sfiduese dhe të arrijë objektivin për të cilin është dizajnuar. Angazhimi i përbashkët i pjesëtarëve në ekipet e tyre dëshmoi për rëndësinë që ka individi në ekip si dhe rëndësinë që ka puna ekipore në arritjen e suksesit të përbashkët. Gjithashtu është për t'u vlerësuar dhe angazhimi i Shtabit të Brigadës, rreshterit të parë dhe ekipit të instruktorëve, të cilët me sukses arritën të menaxhojnë organizimin dhe realizimin e kësaj gare. Planifikimi dhe organizimi profesional, vlerësimi transparent dhe rritja e interesimit për pjesëmarrje janë shenjat më të mira që gara "Ujku Garues" është duke evoluar dhe zhvilluar edhe më tej".Në fund të garës, në bazë të performancës së treguar, në mënyrë transparente u bë përzgjedhja e tri vendeve të para të cilat u vlerësuan me çmime si në vijim: Vendi i tretë-BRSH-Batalioni i Tretë-K3A, vendi i dytë-BRSH-Batalioni i Parë, Ekipi i Tretë dhe vendi i Parë-BRSH-Batalioni i Dytë K2B. Nga komandanti i BRSH-së, tri vendet e para u shpërblyen me Emblemën e BRSH-së, të gjitha ekipet pjesëmarrëse me certifikata, ndërsa rreshter majorja amerikane Reachel Fails u nderua me mirënjohje.





FSK-ja vëzhguese në ushtrimin e përbashkët të kërkim-shpëtimit "Anatolian Star" në Izmir të Turqisë



Nga data 02 deri më 04 maj 2017, në regjionin detar dhe malor të Izmirit të Turqisë u mbajt ushtrimi i forcave të përbashkëta të kërkim-shpëtimit "Anatolian Star". Përveç forcave ekzekutuese të ushtrimit nga ushtria turke, morën pjesë edhe delegacionet e 12 shteteve në mesin e të cilave edhe delegacioni i FSK-së, në përbërje: shefi i Sektorit për Plane, Programe dhe Analiza në MFSK, nënkolonel Sefer Isufi, atasheu ushtarak në Turqi, nënkolonel Bekim Osmani dhe atasheu policor në Turqi, z. Blerim Dajaku. Faza e parë e ushtrimit u zhvillua në ujërat ndërkombëtare dhe në hapësirën ajrore të Detit Egje, dhe u realizua nga ana e trupave të Rojës Bregdetare të Forcave Turke, sipas skenarit të planifikuar dhe të koordinuar përmes sistemit satelitor për kërkim-shpëtimin e ekuipazhit të anijes së përfshirë nga zjarri para përmbytjes. Faza e dytë e ushtrimit u mbajt në lokacionin Menemen të qarkut të Izmirit, sipas skenarit për kërkim-shpëtimin e alpinistëve të humbur. Oficerët tanë në këtë ushtrim ishin në cilësinë e vëzhgueseve, krahas oficerëve të shteteve tjera pjesëmarrëse, performanca e të cilëve u vlerësua lart nga ana e nikoqirit, komandantit të operacionit, shefit të Shtabit të Armatës së Egjeut, gjeneral Özgür Nuhut. Duke pasur parasysh se FSK-ja njësitë e saj të kërkim-shpëtimit i ka në nivel të lartë profesional, në takimin e realizuar me nikoqirin u diskutua edhe mundësia e pjesëmarrjes së një togu të kërkim-shpëtimit të FSK-së në ushtrimin e ardhshëm. Në fund të ushtrimit, nënkolonel Sefer Isufi në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralit Nuhut i dorëzoi stemën e FSK-së, në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për ftesën dhe mbështetjen që forcat turke treguan në avancimin e kapaciteteve dhe aftësive operacionale të Njësisë së Kërkim-Shpëtimit të FSK-së. Ky ushtrim gëzoi vëmendje maksimale jo vetëm të mediave turke por edhe të atyre ndërkombëtare, për shkak të zhvillimeve në Zonën e Mesdheut e posaçërisht të operacioneve sistematike për shpëtimin e emigrantëve ilegalë të zhvendosur nga zonat e luftës të cilët me varka ia mësynin brigjeve evropiane.

Institucionet dhe Agjencitë e Kosovës për menaxhimin e krizave realizuan ushtrim të përbashkët





Në kazermën "Evropianët e Rinj" në Pomozotin, u mbajt sot ushtrimi fushor i institucioneve dhe agjencive të Kosovës për menaxhimin e krizave në raste të incidenteve me tren. Në këtë ushtrim ishin të përfshira njësitet e këtyre institucioneve dhe agjencive: Ambasada Amerikane, KFOR-i Amerikan, Forca e Sigurisë së Kosovës, Agjencia për Menaxhim të Krizave, Policia e Kosovës, Hekurudhat e Kosovës, Zjarrfikësit, tri brigada (Prishtinës, Drenasit dhe Llapnasellës), Kryqi i Kuq i Kosovës, dega në Fushë Kosovë dhe Stafi nga Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë. Për ta përcjellë nga afër këtë ushtrim ishin të pranishëm edhe: zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zv. komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) kolonel Avdi Raci, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) kolonel Shaip Haziri, udhëheqësi i ekipit për mbështetje nga Ambasada Amerikane kapiten Peter Preisinger, zv. kryeshefi i Trainkos-it Naim Neziri, drejtori i Departamentit të Operimeve në Trainkos, drejtori i Departamentit të Gatishmërisë në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave Hajriz Sejdiu, drejtori i Departamentit të Parandalimit në Agjencinë e Emergjencave Alush Beqiri etj. Me këtë rast gjeneral brigade Gëzim Hazrolli përshëndeti dhe përgëzoi institucionet e përfshira në këtë ushtrim për bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë këtij ushtrimi. "Jemi shumë të kënaqur me planifikimet dhe realizimet e shumta që i kemi zhvilluar viteve të fundit. Edhe ushtrimi i sotëm ishte me rëndësi të veçantë për ne, sepse nxjerr mësimet e mësuara në ngritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunimin në menaxhimin e krizave në të ardhmen, me të vetmin qëllim që të shpëtojmë jetë njerëzish në Kosovë",- tha nder të tjera gjeneral Hazrolli.

Certifikohen 30 pjesëtarë të FSK-së, në seminarin "Koha e rreshterit për trajnim"

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjegjësisht në Batalionin e Xhenios, u mbajt ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve të cilët përfunduan trajnimin një javor "Koha e rreshterit për trajnim".Në këtë ceremoni të pranishëm ishin: Gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, kolonel Naim Haziri, shef i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore si dhe oficerë e nënoficerë të FSK-së dhe KFOR-it. Fillimisht të pranishmëve ju drejtua gjeneral Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, i cili pasi përshëndeti dhe falënderoi instruktorët e Gardës Kombëtare të IOWA-s, për kontributin e vazhdueshëm që janë duke e dhënë në zhvillimin e korit të nënoficerëve të FSK-së, si dhe shtetet që po ndihmojnë FSK-në, ndër tjera, tha: "Sukseset e juaj gjatë këtij seminari, dhe sukseset e FSK-së në përgjithësi, po na bëjnë të ndihemi krenar me ju. Këto arritje individuale dhe kolektive janë tregues më i mirë që FSK-ja po arrin suksese të shkëlqyeshme si brenda dhe jashtë vendit, së bashku me partnerët tanë dhe sidomos me Gardën Kombëtare të Ajovës".Më tej, gjeneral Halimi, tha se: "Qëllimi i mbajtjes së këtij seminari është shkëmbimi i përvojave lidhur me kanalin mbështetës të nënoficerëve, dhe jam shumë i kënaqur me arritjet që janë bërë deri më tani në këtë fushë, ku fokusi i këtij seminari ka qenë tek "Koha e Rreshterit", të cilën ne jemi duke e aplikuar në njësitë tona dhe po tregojmë rezultate pozitive në ngritjen e performancës në njësi. Më vjen mirë që pjesëmarrës në këtë seminar kanë qenë edhe oficerët; kjo ju ndihmon atyre të kuptojnë edhe më mirë rolin e nënoficerit në njësi por edhe t'i identifikojnë fushat ku ata duhet t'ju japin më tepër mbështetje nënoficerëve. Ne kemi punuar në konceptin për zhvillimin e NOF për një periudhë 3-5 vjeçare, mirëpo ne duhet të vazhdojmë t'i identifikojmë nevojat për zhvillimin sa më të mirë të nënoficerëve dhe t'i inkorporojmë ato në këtë koncept".Gjeneral Halimi më pastaj nga pjesëtarët e FSK-së, të sapo certifikuar, kërkoi që të gjitha njohurit e fituara nga ky seminar t'i bartin me sukses te njësitet e tyre, me qëllim që me këto njohuri të pajisen edhe kolegët tjerë, nëpër njësi. Ndërsa, rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj dhe rreshter majorja e Komandës së Gardës së Ajovës, Rachel Fails, folën për mbajtjen dhe rendësin e seminarit, duke theksuar se të gjithë pjesëmarrësit gjatë seminarit treguan interesim dhe gatishmëri për të pajisur me njohuri të reja. Në fund, gjeneral brigade Zymer Halimi u ndau certifikatat instruktorëve të Gardës Kombëtare të AJOVËS.



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ndau mirënjohje për kompanitë private që ndihmuan profesionalizmin e FSK-së

Komandanti Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ndau sot (23 maj 2017) Mirënjohje disa kompanive vendore nga fusha e mekanikës, në pritjen që ai rezervoi për përfaqësuesit e këtyre kompanive, të cilat kanë mbështetur ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve profesionale të mekanikës së FSK-së. Me këtë rast, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti koordinatorin e Projektit të Partneritetit për Arsim Profesional në Kosovë, z. Franc Musolli, pastaj z. Faik Salihun nga Shkolla e Mesme Profesionale ,,Shtjefën Gjeçovi"në Prishtinë, z.Feriz Hoxha, përfaqësues i ,,AHP"në Prizren, z. Haki Abdullahu, përfaqësues i ,,BAKI"në Llapnasellë, z. Skënder Kaqandolli, përfaqësues i kompanisë ,,Kaqandolli"në Prishtinë, si dhe përfaqësuesin e Odes Ekonomike të Kosovës dhe nënkolonelin gjerman Michael Gierse, këshilltar në Departamentin e Logjistikës së FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama fillimisht i falënderoi përfaqësuesit e kompanive vendore dhe ata të Odes Ekonomike të Kosovës dhe Odes Zejtare të Dortmundit-Gjermani, për bashkëpunimin si dhe ofrimin e përkrahjes dhe mbështetjes në profesionalizimin e pjesëtarëve të FSK-së, në mirëmbajtje të automjeteve të FSK-së. Gjithashtu, gjeneral Rama tha se; "Forca e Sigurisë së Kosovës është në proces të vazhdueshëm të ngritjes dhe avancimit të kapaciteteve profesionale në të gjitha fushat, e me theks të veçantë është e përkushtuar që të profesionalizojë kuadro për mekanikë dhe mirëmbajtje të automjeteve, që tani dhe në të ardhmen të përkujdeset me kapacitetet e veta për makinerinë që posedon dhe këtë mirëmbajtje ta bëj sipas standardeve të NATO-s në mënyrë që kudo që vepron dhe kudo ku angazhohet të jetë e ndërvepruseshme". Ndërsa, nga ana e tyre të gjithë afaristët u shprehën të gatshëm, që edhe në të ardhmen ta përkrahin Forcën e Sigurisë së Kosovës në avancimin e kapaciteteve profesionale dhe çmuan lartë angazhimin e pjesëtarëve të FSK-së, gjatë kryerjes së kurseve të mekanikës. Në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama ndau mirënjohje për Odën



Ekonomike të Kosovës dhe Odën Zejtare të Dortmundit, si dhe për përfaqësuesit e kompanive, me motivacion: ,,Për kontributin e jashtëzakonshëm në ngritjen dhe zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me rastin e mundësimit të trajnimit profesional në fushën e automekanikes për mirëmbajtjen e mjeteve të motorizuara sipas standardeve gjermane të aftësimit profesional".

Kadetët e Kosovës në shënimin e Ditës së Personelit Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura të Turqisë

Më datën 21.05.2017 në Akademinë Ushtarake të Forcave të Armatosura Turke në Ankara, është shënuar Dita e Personelit Ushtarak Mysafir (MAP Günü). Në këtë ditë, i gjithë personeli i huaj kishte për detyrë që të përfaqësojë vendin e vet me ushqime, veshje kombëtare, uniformën ushtarake, fotografi me bukuritë natyrore, broshura të ndryshme rreth organizimit dhe aktiviteteve ushtarake etj. Në mesin e 297 kadetëve nga 18 shtete të ndryshme të botës, Republikën e Kosovës e prezantuan edhe 12 kadetët e Kosovës që studiojnë në Akademinë Ushtarake në Turqi, ndërsa të pranishëm ishin edhe kadetët që janë duke vijuar mësimet në Fakultetin e Mjekësisë Ushtarake (GATA). Nën organizimin e atasheut ushtarak të FSK-së në Ankara, nënkolonel Bekim Osmani, ata prezantuan shkëlqyeshëm



Republikën e Kosovës, FSK-në, ushqimet dhe veshjen tradicionale të vendit tonë. Ky lloj manifestimi është tradicional dhe organizohet çdo vit. Tani që kemi edhe atasheun tonë në Turqi, për dallim nga vitet e kaluara, mbështetja për kadetët nga ana e FSK-së, ishte më e madhe dhe çdo gjë shkoi shumë më mirë, falë përkujdesjes së atasheut ushtarak. Përveç komandantit të Akademisë që ishte nikoqir, për ta përcjellë këtë ngjarje kishin ardhur edhe shumë gjeneralë dhe oficerë tjerë të lartë vendorë si dhe atashe nga vende të ndryshme të botës. Gjatë vizitës së tyre tek këndi i Kosovës, nga atasheu ynë ata u njoftuan me atë që kishin përgatitur për përfaqësim duke ua përshkruar në pika të shkurtra historinë dhe bukuritë natyrore të Kosovës. Pas kësaj aktivitetet vazhduan tek këndi i ushqimeve tradicionale, ku të pranishmit patën rastin që të shijojnë ushqime të ndryshme tradicionale nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në Akademinë Ushtarake. Kadetët tanë, në mënyrë të shkëlqyer kishin përgatitur këndin e përfaqësimit dhe këndin e ushqimeve të cilat nuk kaluan pa fjalë miradije nga komandanti i Akademisë Ushtarake dhe të gjithë të pranishmit tjerë. Në fund, atasheu ynë u kujdes që disa mysafirëve të veçantë t'u ndajë nga një dhuratë simbolike me motive nga Republika e Kosovës. Edhe këtë vit, kjo paraqitje u realizua me përkrahjen e FSK-së, Ambasadës së Republikës së Kosovës në Ankara dhe familjeve të stafit të ambasadës.

Certifikohen kadetët në Kursin e Avancuar për Lider në KDS

Në mjediset e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), u mbajt sot ceremonia e certifikimit të kadetëve të Kursit të Avancuar për Lider. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: gjeneral brigade Enver Cikaqi-komandant i KDS, Kolonel Irfete Spahiu- zëvendëskomandant i KDS, Kolonel Predrag OMRCEN këshilltar i ekipit ndërlidhës të NATO-s (NALT) për FSK, si dhe oficerë të FSK dhe NALT-it. Komandanti i KDS-s, gjeneral brigade Enver Cikaqi, mbajti një fjalë rasti duke ju dëshiruar mirëseardhje të pranishmëve dhe suksese kadetëve të certifikuar në këtë ceremoni. Gjeneral Cikaqi vuri theksin te roli dhe rëndësia e trajnimeve për ushtarakët e FSK-së, pa marrë parasysh nivelin dhe njësinë. Ai ndër të tjera tha: " Të gjithë pjesëtarët e FSK-së duhet të jenë të përgatitur për detyra dhe organizime të reja. Përgatitjen tuaj e kam vërejtur edhe gjatë trajnimeve. Ju posedoni veti të mira në menaxhim, udhëheqje dhe disiplinë. Këto janë vetëm disa nga vetitë që duhet t'i posedojë ushtaraku. Dua të ju përgëzoj edhe për angazhimin tuaj gjatë këtij kursi. Njohuritë të cilat i keni fituara këtu nëse i mbani për vete nuk kanë ndonjë efekt, andaj ju këshilloj që këto njohuri t'i shpërndani tek kolegët nëpër njësitë tuaja".Ndërsa, në emër të Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve foli Zv. KOMQZHPU major Skender Haliti, i cili tha: " Kursi i Avancuar për Lider është një kurs sa sfidues po aq edhe tërheqës. Mund të them se kadetët e kësaj gjenerate kanë treguar rezultate të larta, falë angazhimit të instruktorëve dhe interesimit të tyre. Sot nuk kemi nevojë të flasim ne, flasin rezultatet të cilat kadetët i kanë arritur gjatë kësaj periudhe 7 javore, ku ata janë ballafaquar me sfida të ndryshme, sidomos në terren, por motivimi dhe përkushtimi i tyre ka bërë që detyrat t'i realizojnë me sukses".Disa nga temat e këtij kursi ishin: Lidershipi, navigimi tokësor, taktikat luftarake, menaxhimi i trajnimit, ushtrimet fushore, fitnesi fizik etj. Vlen të theksohet se Kursi i Avancuar për Lider është gjenerata e parë për vitin 2017, i cili është përgatitur nga instruktorët e ushtrisë amerikane dhe është përshtatur me nevojat e FSK-së.



Në kazermën e BRSH-së, u realizua ceremonia e certifikimit të trajnimit "Taktikat me njësi të Vogla", Gjenerata 01/2017

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s"të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, në Istog, u mbajt sot (5 maj 2017) ceremonia e certifikimit të 47 pjesëtarëve të cilët përfunduan trajnimin ,,Taktikat me Njësi të Vogla".Në këtë ceremoni të pranishëm ishin: Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, ushtruesi i detyrës së komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir GECI, zëvendëskomandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale kolonel Avdi RACI, shefi i Shtabit të BRSH-së nënkolonel Ejup Maqedonci, këshilltari i KOMFSK-së, kolonel Lindsay si dhe oficerë e nënoficerë të Shtabit të BRSH-së. Fillimisht të pranishmëve ju drejtua ushtruesi i detyrës së komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir GECI, i cili ndër tjera tha: "Pjesëtarët e BRSH-së si në nivelin individual ashtu edhe në atë kolektiv janë duke vazhduar edhe këtë vit të përfaqësojnë në mënyrën më të mirë veten e tyre, institucionin dhe shtetin tonë. Këtë e dëshmojnë rezultatet e larta që ata po arrijnë si në gara ashtu edhe në shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit. Një ndër trajnimet më të veçanta që planifikon, organizon dhe realizon BRSH-ja është trajnimi "Taktikat me Njësi të Vogla".E veçanta e këtij trajnimi këtë vit ka qenë përfshirja e pjesëtareve femra, të cilat përkundër sfidave dhe programit intensiv kanë arritur që me përkushtim dhe vullnet të jashtëzakonshëm të përfundojnë këtë trajnim në mënyrën më të mirë. Ai, me këtë rast, i përgëzoj pjesëtaret e këtij trajnimi për angazhimin dhe vullnetin që treguan dhe kërkoi nga ta që t'i mirëmbajnë shkathtësitë e fituara dhe njohuritë t'i shpërndajnë në njësitë e tyre. Po ashtu të pranishmëve ju drejtua edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, "Ne, si FSK po arrijmë suksese të mëdha, gjë që dëshmon se jemi forcë profesionale dhe e përgatitur mirë. Por nuk duhet të kënaqemi me kaq, duhet të vazhdojmë punën në realizimin e objektivave tona që të jemi pjesë e Aleancës Veri Atlantike-NATO-s".Për mbarëvajtjen e trajnimit foli edhe përgjegjësja e këtij trajnimi, toger Manushaqe Nura, e cila nder të tjera u shpreh; "Pjesëtarët u sfiduan në shumë disiplina, por ata treguan performancë dhe lidership gjatë kësaj periudhe 4 javore, ku shumica e trajnimit u realizua në terren".Ndërsa, këshilltari britanik i KOMFSK kolonel Lindsay, i uroi pjesëmarrësit për përfundimin me sukses të trajnimit, "E di që ka qenë trajnim sfidues dhe i vështirë, sepse është i njëjti që kryhet edhe në SHBA apo Britani të Madhe, andaj ju përgëzoj për ketë, tani do të jeni më të përgatitur në të gjitha sfidat që mund të përballeni. Trajnimi ,,Taktikat për Njësi të Vogla" ka filluar më 11 prill 2017 dhe ka zgjatur deri më 05 maj 2017.Në kuadër të pjesëmarrësve në trajnim,përveçpjesëtarëve të tri batalioneve të BRSH-së,kanë marrë pjesë edhe katër pjesëtarë nga BMO-ja dhe dy pjesëtarë nga KDS-ja. Kjo ka qenë gjenerata e parë për vitin2017, kurse e 13-ta më radhë, e cila është planifikuar dhe realizuar nga Brigada për Reagim të Shpejtë.



Gjatë këtij trajnimi pjesëtarët janë pajisur me njohuri në fusha të ndryshme si në teori ashtu edhe në praktikë, ndërsa fokus kryesor i trajnimit ka qenë ngritja dhe profesionalizimi i pjesëtarëve të BRSH-së dhe njësive tjera të FSK-së për kryerjen e detyrave taktike për realizimin sa më mirë të misionit të tanishëm dhe atë të ardhshëm. Temat e trajtuara gjatë trajnimit janë: Aftësimi i pjesëtarëve në udhëheqje dhe operim me ekipe dhe skuadra, Patrullat, Rikonicion, Repilim, Navigim Tokësor i kombinuar ditën dhe natën, Prita, Reagimi në Kontakt, Qitja taktike dhe stresuese me armë, operacione urbane dhe tema tjera që janë po ashtu të një rëndësie të veçantë për FSK-në në përgjithësi. Sfidat që janë përballur pjesëmarrësit në ketë trajnim kanë ndërtuar pjesëtarë profesionalë të cilët pa marrë parasysh kushtet dhe rrethanat janë të gatshëm të operojnë në të gjitha detyrat që u caktohen nga komanda madhore. Për pjesëtarët të cilët kanë përfunduar këtë trajnim u ndanë certifikata, ndërsa për më të dalluarit shpërblime dhe për instruktorët mirënjohje.

Mbahet kursi "Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin më të gjerë të sigurisë në Kosovë dhe rajon"

Gjatë muajve prill dhe maj (23.04-05.05.2017) është zhvilluar kursi "Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin më të gjerë të sigurisë në Kosovë dhe rajon", i organizuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe i realizuar nga Universiteti Cranfield dhe Ministria e Mbrojtjes së Britanisë së Madhe. Kursi është mbajtur në dy pjesë dhe ka zgjatur dy javë; java e parë është realizuar në Prizren, ndërsa java e dytë në Prevallë. Nga MFSK-ja dhe FSK-ja kanë marrë pjesë 14 pjesëtarë, nga institucionet tjera të Kosovës 12 pjesëmarrës (IPK, Doganat, PK, QS, MPJ, QSSK etj.), si dhe 5 pjesëmarrës nga Republika e Shqipërisë dhe 2 pjesëmarrës nga Republika e Maqedonisë. Hapja zyrtare e kursit është bërë nga atasheut ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Richard Parry. Kursi "Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin më të gjerë të sigurisë në Kosovë dhe Rajon" kishte për qëllim ngritjen e nivelit të njohurive të pjesëmarrësve, në mënyrë që të përmirësohet qeverisja dhe menaxhimi në sektorin e sigurisë, që do të krijonte mundësi për arritjen e objektivave dhe ndërtimin e një vizioni të përbashkët të çështjeve kyçe në lidhje me sigurinë kombëtare, rajonale dhe globale. Programi i kursit ishte hartuar në atë mënyrë që pjesëmarrësit të marrin njohuri dhe të përparojnë në: të kuptuarit e politikave, strategjive dhe hartimin e tyre; ndërlidhjen e koncepteve teorike të qeverisjes; rifreskimin e koncepteve që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, transparencën dhe llogaridhënien, menaxhimin e shërbimeve të sigurisë. Pra, objektiv i kursit ishte arritja e standardeve më të larta profesionale duke përfshirë edhe mekanizmat që mundësojnë menaxhimin efektiv të ndryshmeve brenda sektorit të sigurisë. Familjarizimi me normat ligjore vendore dhe ndërkombëtare si dhe familjarizimi me kornizat relevante për qeverisjen e sigurisë përbënte një kapitull të veçantë të kursit. Kursi ka përmbushur synimet e përcaktuara, duke u bazuar në nivelin e lartë të ligjëruesve dhe në cilësinë e ligjëratave të cilat ishin mjaft të rëndësishme dhe përmbajtjesore. Gjatë kursit janë zhvilluar rreth 20 ligjërata dhe gjashtë ushtrime që janë ndërthurur edhe me prezantime individuale dhe grupore. Disa nga prezantimet kanë trajtuar temën e transformimit të FSK-së në FAK, me ç' rast janë shqyrtuar përparësitë, pengesat ligjore, mbështetja regjionale dhe ndërkombëtare si dhe gjetja e mundësive për të arritur qëllimin e dëshiruar. Pjesëtarët e MFSK/FSK-së kanë qenë mjaft aktivë dhe kanë kontribuar në rrjedhën e kursit, duke treguar interesim të lartë për t'u pajisur me sa më shumë njohuri. Në ceremoninë e certifikimit-përmbylljes ka marrë pjesë edhe drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi, i cili njëherë, edhe u ka nda certifikatat pjesëmarrësve. Kurset e tilla, të organizuara nga Ambasada e Britanisë e të mbajtura nga Universiteti Cranfield dhe Ministria e Mbrojtjes së Britanisë së Madhe, janë mjaft të rëndësishme për institucionet e sigurisë, natyrisht edhe për FSK-në.



FSK-ja mori pjesë në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën"

FSK-ja, për të gjashtin vit me radhë, po e përkrahë aksionin vullnetar "Ta pastrojmë Kosovën" me ushtarë, mjete teknike, ekskavatorë dhe kamionë. Bazuar në planin e Veprimit të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak (DBCU) dhe në koordinim të aktiviteteve me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe drejtuesit e Organizatës joqeveritare "Ta pastrojmë Kosovën" dje, u realizua aktiviteti me moton "Ta pastrojmë Kosovën" në Prishtinë dhe komunat tjera të Kosovës. Në kryeqytet, aksioni "Ta pastrojmë Kosovën" filloi në lagjen "Arbëria" në të cilën morën pjesë nxënës të shkollave të mesme, pjesëtarë të FSK-së, qytetarë dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme. Me këtë rast, nënkoloneli i FSK-së, Afrim Veseli, në emër të FSK-së e ka përshëndetur aksionin për pastrimin e ambientit jo vetëm në kryeqytetin e Kosovës, por në tërë Kosovën, duke shtuar se, "ky aksion tani më është bërë tradicional, ku FSK-ja po kontribuon sado pak në pastrimin e ambientit tonë e që është në të mirë të gjithë qytetarëve të Kosovës. FSK-ja, në aksionin ta pastrojmë Kosovën, po merr pjesë në pastrimin edhe të ambienteve të kazermave të FSK-së, si dhe në pastrimin e qyteteve; në Prishtinë, Istog, Ferizaj, Mitrovicë, Gjilan dhe Prizren, me makineri dhe ushtarë ". "FSK-ja gjithmonë është e gatshme tu del në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe t'i përkrahë edhe përmes aksioneve të tilla, që janë në shërbim dhe interes të tyre" tha në fund nënkoloneli Afrim Veseli.



Orkestra e FSK-së përformon në kazermën 'Sulltan Murat' në Prizren




Forca e Sigurisë së Kosovës së bashku me udhëheqësit e kampit ushtarak turk, në kuadër të bashkëpunimit me partnerët, në kazermën "Sulltan Murat" në Prizren, kanë realizuar një aktivitet kulturor me Orkestrën Frymore të Forcës së Sigurisë të Kosovës për ushtarët dhe oficerët e KFOR-it turk që shërbejnë në Kosovë. Për të përcjellë nga afër performancen ishin të pranishëm drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës gjeneral brigade Zymer Halimi, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile kolonel Shaip Haziri, mysafirë të shumtë, si ministri Mahir Jagxhilar, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike Turke të Kosovës, si dhe oficerë e ushtarë të KFOR-it turk me shërbim në Kosovë. Nikoqiri i këtij organizimi, komandanti i kontingjentit turk në Kosovë, kolonel Mustafa Tavazar, gjatë fjalës së tij të mbajtur me këtë rast ndër tjera tha: "Falënderoj të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje dhe njëherësh dua të shpreh kënaqësinë time për profesionalizmin e Orkestrës së FSK-së, e cila para pak javësh kishte performuar së bashku me Orkestrën nga Turqia në mjediset e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ne, po atë ditë bëmë kërkesë tek ZVKOM i Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli që të organizojmë një koncert këtu, në kazermën tonë, dhe kërkesa jonë u miratua nga ministri i FSK-së z. Haki Demolli, dhe tani jemi këtu që të përcjellim së bashku interpretimin e bukur të kësaj orkestre".Gjatë këtij koncerti, ku u luajtën vepra dhe marshe të shumta si dhe u interpretuan këngë të bukura në gjuhën turke, të gjithë të pranishmit patën mundësi që të argëtohen dhe të shijojnë interpretimin e tyre të mrekullueshëm nga Orkestra Frymore e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në fund komandanti i kontingjentit turk, në shenjë falënderimi ndau mirënjohje për Orkestrën e FSK-së.

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës certifikohen për "Brezin e Gjelbërt"



Nëntë pjesëtarë të njësive të ndryshe të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) u certifikuan sot për Brezin e Gjelbërt nga instruktorët e Marinsave Amerikan. Në këtë ceremoni të certifikimit e cila u mbajt në kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, të pranishëm ishin Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zv. komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Irfete Spahiu si dhe eprorë të lartë të FSK-së dhe mysafirë nga Ambasada Amerikane. Me këtë rast, të pranishmëve ju drejtua gjeneral Rama i cili e falënderoi ambasadën Amerikanë për përkrahjen e vazhdueshme qe janë duke e bërë për pjesëtarët e FSK-së, dhe shtoi: "falënderoj Ambasadën Amerikane dhe instruktorët e marinsave amerikan për mbështetjen dhe përkrahjen që janë duke i dhënë FSK-së, pa përkrahjen e partnerëve tanë, ne nuk do të ishim këtu ku jemi sot". Gjenerali Rrahman Rama i përgëzoi edhe pjesëtarët e FSK-së për suksesin e treguar gjatë këtij trajnimi " Ju keni treguar gatishmëri, përkushtim dhe vetëbesim gjatë këtij trajnimi dhe shpresoj që këto përvoja që i keni fituar në ,Arte Marciale, t'i përcjellin për njësitë, aty ku shërbeni". I kënaqur nga realizimi i këtij trajnimi u shpreh edhe Komandanti i Detashmentit Marin Security Gard, rreshter i shtabit Morales Wincenti i cili i falënderoj pjesëtarët e FSK-së për bashkëpunim e treguar gjatë këtij trajnimi, dhe shtoi: " dua t'i falënderoj pjesëtarët e FSK-së për mundësinë qe na dhanë të trajnohemi me ju, por edhe për bashkëpunimin dhe përkushtimin që kanë treguar gjatë realizimit të këtij trajnimi". Me këtë ekip i cili u certifikua sot për brezin e gjelbër, do vazhdojmë edhe për brezin e kaftë dhe të zi, duke shpresuar që të organizojmë edhe trajnimin "Trajno Trajnerët" që në të ardhmen instruktorët FSK-së të realizojnë trajnime të tilla për pjesëtarët e saj. Qëllimi i këtij trajnimi i cili u realizua nga dt. 15-26 maj është që krahas ngritjes profesionale ne fushat e tjera, pjesëtarët e FSK te jenë të përgatitur edhe fizikisht në përballimin e çdo lloj sfide, qoftë fizike apo psikike.

Batalioni i Tretë i BRSH-së me sukses realizoi vrapin kondicional "VRAPI-2017"



Batalioni i Tretë i Reagimit të Shpejtë të FSK-së, sot (5 maj 2017) realizoi vrapimin kondicional 10 km "VRAPI-2017". Ky aktivitet u realizuar në bazë të planit vjetor të trajnimeve dhe të aktiviteteve për vitin 2017 të Batalionit të Tretë. Qëllimi vrapimit kondicional është ngritja e nivelit të përgatitjes fizike të pjesëtarëve të Batalionit në distanca të gjata. Në këtë sfidë kanë marrë pjesë 164 pjesëtarë. Vrapimi është realizuar në zonën e përgjegjësisë së Batalionit të Tretë. Pjesëmarrësit e vrapit e kanë përfunduar me kohë vrapimin dhe pa ndonjë problem, gjë që dëshmon se kanë një përgatitje të lartë fizike dhe janë të gatshëm në përballimin e çfarëdo detyre dhe sfide. Në vrapim ka marrë pjesë edhe stafi komandues i Batalionit dhe të katër kompanive të Batalionit të Tretë.

FSK-ja me mjetet financiare të aksionit vullnetar "Vrapo me FSK-në" ndihmon familjet në asistencë sociale të Komunës së Mitrovicës



Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dje në Komunën e Mitrovicës shpërndanë mjete financiare si dhe pako higjienike dhe ushqimore për disa familje në nevojë të kësaj komune. Të gjitha këto mjete të cilat dje u shpërndanë për 10 familje të Mitrovicës, pritet që në ditët në vijim të shpërndahen dhe për 5 familje të tjera nga komunitetet e kësaj komune, u mblodhën falë aksionit vullnetar" Vrapo me FSK-në-Mitrovica 2017", i cili u organizua gjatë muajit prill nga ushtarët dhe oficerët e FSK-së. Ky aktivitet u realizua falë bashkëpunimit të mirëfilltë të FSK-së me Komunën e Mitrovicës, ku njerëzit kompetent të komunës gjatë tërë kohës i kanë mbështetur pjesëtarët e FSK-së në përzgjedhjen e familjeve me në nevojë për t'i ndihmuar. Gjatë shpërndarjes së këtyre fondeve, përveç oficerëve të FSK-së, i pranishëm ishte edhe drejtori i Drejtorisë për Integrime Evropiane dhe Mirëqenie Sociale, z. Qazim Nimani së bashku me stafin e tij, i cili përgëzoi FSK-në për realizimin e këtij aksioni dhe njëherësh falënderoi pjesëtarët e saj për ndihmën e ofruar, të cilën e vlerësoi si mjaft të nevojshme për qytetarët e kësaj komune. Familjet që përfituan nga ky aksion ishin mjaft të lumtura, për vet faktin se po ndihmoheshin, pikërisht, nga pjesëtarët e FSK-së të cilët gëzojnë respekt të veçantë jo vetëm në komunën e tyre por tek të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo, nuk është hera e parë që pjesëtarët e FSK-së organizojnë një aktivitet të tillë dhe sigurisht se nuk do të jetë as hera e fundit, pasi që oficerët e rinj të FSK-së premtuan që më përkrahjen e vazhdueshme të eprorëve të FSK-së dhe më vullnetin e mirë të tyre, ata do të vazhdojnë t'i përkrahin qytetarët e vendit edhe në të ardhmen.

FORCA JONË

□□□ Viti VI □ Nr. 59 □Korrik 2017 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Ministri i FSK-së zoti Haki Demolli priti zëvendës ndihmësin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, zotin John Manza

Ministri FSK-së, zoti Haki Demolli,më 20.06.2017, priti në takim pune zëvendësndihmësin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, zotin John Manza. Në këtë takim z. Demolli shoqërohej nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i Përgjithshëm zoti Shkelzen Sylaj si dhe oficerë dhe zyrtarë të lartë të MFSK-së. Fillimisht ministri Demolli shprehi falënderimet për përkrahjen e vazhdueshme që NATO po i jep MFSK-së dhe FSK-së përmes ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NALT). Ai po ashtu me këtë rast, falënderoi Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, zotin Jens Stoltenberg për letrën që i ka dërguar kryeministrit të Kosovës Isa Mustafa, ku janë identifikuar mundësitë e thellimit të bashkëpunimit, e ku ne synojmë që të arrihet partneriteti i bashkëpunimit në mes Kosovës dhe NATO-s në fushën e sigurisë. Ministri Demolli theksoi bashkëpunimin e mirë me vendet e regjionit, me ushtritë e vendeve mike, veçanërisht me Gardën kombëtare të Ajovës dhe bashkëpunimin e mirë me KFOR-in përmes ushtrimeve të përbashkëta. Temë me rëndësi ishte ajo e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, ku ministri Demolli ritheksoi, se ne jemi të bindur, se vetëm përmes ndryshimeve kushtetuese duhet të bëhet ky ndryshim. Por siç po shihet, procesi ka ngelë edhe më tej, kusht i vendimmarrjes politike, e cila varet nga votat e deputetëve serb e që ngelet sfidë edhe për legjislaturën e ardhshme. Në fjalën e tij komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama foli për përgatitjet dhe planifikimin e ushtrimit Fushor "Shqiponja-6" që do të mbahet në tetor, ku do të jenë pjesëmarrës ushtritë e më shumë se 10 shteteve. Ai foli për aktivitet konkrete që janë bërë për integrimin e komuniteteve pakicë në FSK e



veçanërisht të komunitetit serb, pa ulur asnjëherë kriteret që ka FSK-ja. Ai theksoi se transformimi i FSK-së po e pret vendimin politik, por është me rëndësi të thuhet se ne po punojmë shumë që të jemi gati për atë ditë, dhe për këtë kemi kryer përgatitjet e nevojshme si dhe planifikimet afatmesme dhe afatgjata. Në fjalën e tij, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, zoti Shkelzen Sylaj u fokusua te përgatitja dhe nënshkrimi i strategjisë së MFSK-së, për komunitetet pakicë nga ministri Demolli, pastaj ai foli për hartimin e strategjisë për ndërtimin e integritetit, për planin aksional për ngritje të integritet, projekt i cili po përkrahet nga shteti i Norvegjisë. Po ashtu ai foli për mundësinë që është krijuar për shkollimin e kadetëve të komunitetit serb në akademinë ushtarake të Maqedonisë dhe përfaqësimin e lartë gjinor në FSK dhe ministri. Zoti John Manza nga ana e tij, shprehi kënaqësinë për arritjet dhe kualitetin e lartë të FSK-së. Ai u shpreh se letra e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, zotit Stoltenberg, është dëshmi e përkrahjes që NATO i jep FSK-së. Po ashtu ai vlerësoi lartë punën e mirë dhe rezultatet konkrete për integrimin e komuniteteve pakicë në FSK. Ndër të tjera në takim, zoti Manza theksoi se, transformimi i FSK-së, duhet të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese dhe të mos jetë proces i ngutshëm por ecje me hapa të sigurt. Zoti Manza shoqërohej edhe nga drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë e FSK-së, gjenerali Dietmar Mosmann si dhe zyrtarë dhe oficerë të lartë të NALT-it.

Komandanti i Gardës Kombëtare të IOWA-s gjenerali Timothy Orr vizitoi njësitë e FSK-së

Komandanti i Gardës Kombëtare të IOWA-s,gjeneral majori Timothy Orr, i shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kanë vizituar dje (30.06.2017) Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj si dhe Batalionin e Parë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Gjilan. Në kazermën ,,Skënderbeu" në Ferizaj, ata u pritën nga komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi nga i cili u njoftuan për aktivitetet të cilat është duke i zhvilluar KDS-ja; përgatitje dhe prioritete këto të dhëna nga Komandanti i FSK-së për Komandën e Doktrinës si institucion edukativ dhe me prioritet në fazën e transformimit. Gjenerali Orr, në KDS, ishte shumë i interesuar të dijë për të gjitha proceset që po kalon FSK-ja, si: trajnimet, infrastruktura, përgatitja e stafit dhe





shumë çështje tjera me interes. Vizita ka vazhduar në përcjelljen e disa trajnimeve që janë duke u realizuar në KDS. Ai ka takuar gjithashtu edhe dy pjesëtarët e FSK-së, të cilët kishin zënë vendin e parë, në garën e ,,Ushtarit më të mirë për vitin 2017", tetar Rafet Gashi dhe tetar Binak Podrimqaku, ku gjenerali Orr, u dha nga një mirënjohje për të arriturat e tyre dhe i përgëzoi për suksesin. Vizita e radhës ishte në trajnimin bazik të pjesëtarëve të komuniteteve, ku me këtë rast, gjenerali Orr, theksoi: ,,Ju përgëzoj për punën që jeni duke bërë për t`i shërbyer vendit, duhet të jeni krenar që keni veshur uniformat dhe prezantoni shtetin tuaj, dhe ky është vetëm fillimi, keni një rrugë përpara dhe një karrierë e cila ju pret dhe familja e juaj të jetë krenar me ju".Po këtë ditë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me gjeneralin Timothy Orr dhe zëvendëskomandantin e Brigadës së Reagimit të Shpejt, kolonel Xhevahir Geci, kanë vizituar Batalionin e parë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Gjilan. Delegacioni i lartë u prit nga komandanti i Batalionit të parë,nënkolonel Haki Xhemajli, i cili falënderoi gjeneralin Orr dhe gjeneralin Rama për vizitën dhe bashkëpunimin e shkëlqyer të Gardës Kombëtare të Ajoves që është bashkëpunim në vazhdimësi. Në kuadër të kësaj vizite gjenerali Orr dhe gjeneral Rama, takuan personelin e Kompanisë 1A, të cilët sa po ishin kthyer nga Ushtrimi Fushor i realizuar në fshatin Marec. Gjatë vizitës së tij në Kosovë dhe në FSK, gjenerali Orr, po ashtu ditë më parë, ka vizituar Qendrën për Studime Universitare në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, i cili u prit nga komandanti i QSU-së, major Avni Kiçina, i cili e njoftoi gjerësisht gjeneralin Orr, për të arriturat e përgjithshme të QSU-së, për këtë vit.

Togeri i FSK-së Adison Gara fitoi çmimin "Top Student" në Kursin për Instruktor të Operacioneve Shumëkombëshe në Republikën e Çekisë

Në mesin e 30 studentëve dhe oficerëve pjesëmarrës nga 8 shtete të botës, pjesëtari i Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë (BRSH) të FSK-së, kapiten Adison Gara, më 2 qershor 2017, fitoi çmimin "Top Student", pra studenti më i mirë në përfundimin e Kursit për Instruktor të Operacioneve Shumëkombëshe në Mbështetje të Paqes (Multinational Peace Support Operations Instructor Training Course) mbajtur në Vyshkov të Republikës së Çekisë. Trajnimi ka përfshirë aktivitete të ndryshme rreth përgatitjeve të instruktorëve për operacione paqeruajtëse, dhe është zhvilluar nga data 30 prill deri më 03 qershor 2017, i planifikuar dhe i udhëhequr nga Ekipi Këshillues Ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar (British Military Advisory Team - (BMAT). Pjesëtarët e FSK-së pjesëmarrës në këtë kurs, treguan rezultate të larta si në aspektin



akademik gjithashtu edhe në atë praktik-gjatë zhvillimit të operacioneve. Pjesëmarrja e FSK-së, në Kursin e Instruktorëve të Operacioneve Shumëkombëshe në Mbështetje të Paqes (Multinational Peace Support Operations Instructor Training Course), është në vazhdën e bashkëpunimit dypalësh me Britaninë e Madhe. Qëllimi i kursit është pajisja e instruktorëve me njohuri teknike të nevojshme dhe përgatitja e tyre me aftësi konvencionale ushtarake. Përveç kapitenit Adison Gara, i cili u shpall edhe studenti më i mirë i gjeneratës, këtë kurs e vijuan edhe kapiten Alban Bujupi, togerr Elbasan Sabedini dhe rreshter major Bedri Zuka. Është fakt i njohur se pjesëtarët e FSK-së, qofshin oficerë apo nënoficerë, kudo që po marrin pjesë në studime, ushtrime, trajnime dhe operacione jashtë vendit po tregojnë rezultate të shkëlqyera si në garat individuale dhe ato kolektive.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama në Konferencën "Partneriteti Ndërshtetëror" në Garmish të Gjermanisë

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, mëdatë 15 qershor 2017, ka marrë pjesë në Konferencën e Partneritetit Ndërshtetëror me Gardat Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Kjo konferencë dyditore është mbajtur në Garmish të Gjermanisë, nën patronatin e Komandës Evropiane të SHBA-ve. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë



edhe shefat e ushtrive të Evropës të cilat kanë partneritet ndërshtetëror si dhe komandantët e gardave kombëtare të shteteve partnere. Në këtë takim, ishte prezent edhe komandanti i Gardës Kombëtare të AJOVËS-gjeneralmajori Timothy Orr, me të cilën FSK-ja ka të nënshkruar marrëveshjen "Partneritet për bashkëpunim" i cili bashkëpunim është shumë intensiv dhe i gjerë. Qëllimi i mbajtjes së kësaj konference ishte rritja e aktiviteteve të përbashkëta; sinkronizimi i bashkëpunimit, rritja e rolit të shteteve partnere në forcimin e partneritetit shtetëror dhe arritja e ndër veprueshmërisë në mes ushtrive të Shteteve të Evropës dhe Forcave të Armatosura të SHBA-ve, në ballafaqim me sfidat bashkëkohore.

Ministri Haki Demolli priti gjeneralin amerikan Timothy Orr

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), zotëri Haki Demolli priti sot (29.06.2017) në takim komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majorin Timothy Orr. Me këtë rast, ministri Demolli falënderoi gjeneralin Orr për vizitën dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që ka treguar në vazhdimësi Garda Kombëtare e Ajovës për FSK-në, si dhe në veçanti e falënderoi gjeneralin për gatishmërinë e tij, për thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Nga ana e tij, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Timothy Orr u shpreh se vlerëson lart profesionalizmin dhe të arriturat e deritashme të FSK-së, duke e siguruar ministrin se mbështetja për Ministrinë dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës do të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen. Gjithashtu, gjenerali amerikan shprehu përkrahjen e tij për FSK-në, edhe lidhur ma hapat, që ajo ka ndërmarrë për integrimin e pjesëtarëve të komunitetit serb, në radhët e saj, gjë të cilën edhe është duke e bërë me mjaft sukses, sidomos në vitet e fundit. Gjenerali Orr së bashku me një delegacion ushtarakësh të Garda Kombëtare dhe të Qeverisë së Ajovës, po qëndrojnë për vizitë në vendin tonë, në kuadër të bashkëveprimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të parapara sipas marrëveshjes së partneritetit shtetëror Kosovë-Ajovë.



FSK në stërvitjen ndërkombëtare "Combined Resolve VIII-të" në Gjermani

Një Kontingjent i FSK-së,sapo u kthye nga pjesëmarrja në stërvitjen ndërkombëtare ,,Combined Resolve VIII" e cila u mbajt në Gjermani. Pjesëmarrja e FSK-së, është realizuar me ftesë të Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë. Ushtrimin Fushor i NATO-s ,,Combined Resolve VIII" (Zgjidhja e Kombinuar -VIII) është mbajtur në bazën e Ushtrisë së SHBA-ve për Evropë në Hohenfels të Gjermanisë, nga data 24 maj-16 qershor 2017. Bartës kryesor të ushtrimit kanë qenë forcat ushtarake Amerikane me anëtarët tjerë të NATO-s dhe partnerët me pjesëtarë nga shtetet e ndryshme, si nga: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Rumania,





Hungaria, Ukraina, Italia, Norvegjia, Finlanda, etj. Në ushtrim janë kryer manovra ushtarake me forca të kombinuara në nivel brigade si operacione të mbrojtjes, sulmit dhe mbijetesës. Kontingjenti i FSK-së ka qenë i përbërë nga 12 pjesëtarë i cili është integruar si pjesë e Batalionit Xhenier të Brigadës 588 të Ushtrisë së SHBA-ve. Në këtë ushtrim pjesëtarët e FSK-së, kanë treguar nivel të lartë profesionalizmi dhe përkushtimi në kryerjen e detyrave, duke treguar shkathtësi të koordinimit dhe ndërveprimit me pjesëtarë të ushtrive tjera pjesëmarrëse si: bashkëpunimi dhe koordinimi me forcat ushtarake të Shqipërisë, me ushtarët e njësive amerikane dhe ato pjesëmarrëse nga shtetet tjera për operim të përbashkët. Gjatë ushtrimit janë demonstruar patrullimet ushtarake në zonat e luftës me forcat mike amerikane, pastrimi i rrugëve nga mjetet e rrezikshme, komunikimi përmes radiove, tipit HARRIS, si dhe operimi i ekipeve të EOD-së (Për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera).Për kryerjen me sukses të gjitha detyrave gjatë misioneve që ju kanë dhënë kontingjentit të FSK-së, ajo është lavdëruar nga komandanti i Batalionit Xhenier të Brigadës 588 të ushtrisë së SHBA-ve.

Kadetët e FSK-së në ushtrimin fushor- ndërkombëtar "Kampi veror 2017" në Krivollak të Maqedonisë

Kadetët e Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës, u nisën të hënën (30 qershor 2017), për në Republikën e Maqedonisë, për të marrë pjesë në ushtrimin fushor ndërkombëtar të kadetëve "Kampi veror 2017" në Krivollak dhe Pepelishtë të Maqedonisë. Ushtrimi ndërkombëtar i kadetëve ka karakter garues dhe organizohet nga Akademia Ushtarake e Maqedonisë, ku do të zgjasë deri më 10.07.2017. Pjesëmarrës do jenë kadetë nga 13 shtete të Botës, ndërsa FSK-ja do të përfaqësohet nga një kontingjent prej 10 kadetëve të QSU-së. Për t'i përcjellë kadetët për në Republikën e Maqedonisë kishin dalë shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, nënkolonel Bekim Zejnullahu nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) si dhe komandanti i QSU-së, major Avni Kiqina. Me këtë rast, koloneli Haziri, uroj kadetët e FSK-së, duke u dëshiruar suksese gjatë këtij trajnimi, të cilin e vlerësoi si mjaft sfidues dhe të rëndësishëm për QSU-në dhe FSK-në në përgjithësi. Njëherësh ai kërkoi nga kadetët që të jenë të disiplinuar dhe bashkëpunues me njëri-tjetrin, në mënyrë që të arrijnë ta përfaqësojnë FSK-në sa më denjësisht. Kjo është hera e gjashtë që kadetë të FSK-së, marrin pjesë në ushtrime të këtij lloji bashkë me kadetë nga shtete të ndryshme, të cilët vazhdimisht kanë arritur suksese dhe janë dalluar me paraqitjen e tyre të shkëlqyeshme si në operacione individuale ashtu edhe dhe ato kolektive.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama "Qytetar Nderi" i Mitrovicës

Në Mitrovicë, sot (30.06.2017) u organizua ceremonia e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" i Mitrovicës,komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës, nga kryetari i komunës Agim Bahtiri. Sipas kryesuesit të Kuvendit të Mitrovicës, zoti Bislim Imeri, dhënia e këtij titulli u bë me iniciativën e kryetarit Bahtiri, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill të këtij viti. Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka marrë vendim që gjenerallejtënant Rrahman Ramës-Komandant i Forcës së Sigurisë të Kosovës, t'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Mitrovicës, me motivacion: "Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në luftën për lirinë e pavarësinë e vendit dhe sidomos në organizimin e mobilizimin e Zonës Operative të Shalës së Bajgorës, mbrojtjen e qytetarëve të komunës nga forcat ushtarako-policore dhe paramilitare serbe; në ofrimin ndihmës për popullatën e Komunës së Mitrovicës dhe të rajonit të Drenicës para dhe gjatë luftës, si dhe në stabilizimin e gjendjes së sigurisë pas lufte". Në Fjalën e tij, kryetari i Komunës së Mitrovicës, zoti Agim Bahtiri, duke ju drejtuar gjeneralit Rrahman Ramës, ndër të tjera theksoi: "Ju me bashkëluftëtarët tuaj të lirisë dhe me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare bëtë realitet shpresën tonë për jetë, liri, pavarësi dhe demokraci. Gjenerallejtënant Rrahman Rama është shquar si organizator i shkathët e luftëtar i denjë, prandaj kontributi i tij dhe luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është shumë i madh. Ata e nxorën përfundimisht Kosovën dhe popullin e saj nga terri i robërisë. Ai ka qenë shumë aktiv sidomos gjatë lëvizjes së përgjithshme për liri e pavarësi. Ishte një komandant i shkëlqyer i Zonës Operative të Shalës, ku bashkë me ushtarët e tij zhvilloi luftërat më të rrepta kundër okupatorit". Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama,në fjalën e tij falënderuese, duke mos fshehur emocionet,i përqendruar në detyrat e tashme që kemi karshi qytetarëve dhe vendit tonë tha: "Është obligim i të gjithë neve të respektojmë amanetin e dëshmorëve dhe gjakun e derdhur për këtë vend. Të punojmë dhe kontribuojmë për ndërtimin e shtetit të lirë



dhe demokratik, për një të ardhme më të mirë për të gjithë. E kemi për obligim që të vendosim themele të shëndosha për gjenerata të reja, që ata të vazhdojnë në zhvillimin e Republikës së Kosovës, ku të gjithë gëzojnë të drejtat dhe mundësi të barabarta". Këtë ceremoni, komandanti i FSK-së, shoqërohej nga drejtori i Drejtorisë së Operacioneve në MFSK-gjeneral brigade Zymer Halimi si dhe oficerë të tjerë të lartë të FSK-së.

Gjermania dhuron Donacion për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Sot, (14.06.2017) drejtori i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjeneral brigade Zymer Halimi, së bashku me shefin e Shtabit të Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, pritën në takim pune zëvendës ambasadoren e Republikës së Gjermanisë në Prishtinë, znj. Christina Gehlsen e cila shoqërohej nga koloneli gjerman Michael Gierse, këshilltar në Departamentin e Logjistikës të MFSK-së. Takimi kishte në fokus vazhdimin e bashkëpunimit si dhe dhënien e një donacioni për mirëmbajtjen e automjeteve të FSK-së, në vlerë prej 50.000 euro nga Qeveria e Gjermanisë. Ceremonia e pranim-dorëzimit të donacionit Gjerman u bë në Brigadën e Mbështetjes Operacionale (BMO) të kazermës "Adem Jashari" në Prishtinë, ku ishin të pranishëm drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), gjeneral brigade Zymer Halimi,



zëvendës ambasadorja e Gjermanisë në Kosovë, znj. Chrisitna Gehlsen, koloneli Gjerman MichaelGierse, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri si dhe eprorë të FSK-së. Me rastin e pranim-dorëzimit të këtij donacioni, gjenerali Zymer Halimi, në emër të FSK-së ka falënderuar zëvendës ambasadoren Gehlsen për mbështetjen dhe ndihmat e vazhdueshme që Qeveria e Gjermanisë po jep për FSK-në. "Falënderojmë shtetin gjerman për kontributin që është duke e dhënë në vazhdimësi në fushën e logjistikës për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ne do vazhdojmë më trajnime të ndryshme, me qëllim të ngritjes dhe aftësimit të pjesëtarëve tanë. Të gjitha këto pajisje më se të nevojshme për ne, të dhuruara sot nga shteti Gjerman, do t'i fusim në përdorim". E kënaqur nga realizimi i këtij donacioni u shpreh edhe zëvendës ambasadorja znj. Chrisitna Gehlsen e cila pos tjerash tha: "ky donacion është vazhdimësi e donacionit të mëhershëm të automjeteve për Forcën e Sigurisë së Kosovës, dhe këto vegla do ju mundësojnë që automjetet të jenë sa më funksionale". Dhurimi i këtij donacioni të sotëm dhe donacioneve të mëhershme për Forcën e Sigurisë së Kosovës është rezultat i një bashkëpunimi mjaft të mirë në mes të këtyre dy shteteve.

Oficerë të ambasadës së SHBA-ve vizitojnë Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj


Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi së bashku me stafin e tij, priti sot,(06.06.2017) në një vizitë pune shefin e Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes (ODC) të Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, majorin Brian Delvin dhe atasheun e Mbrojtjes major Juan Murillo. Me këtë rast, gjenerali Enevr Cikaqi falënderoi ekipin e ODC-s për ndihmën që Ambasada e SHBA-ve, është duke dhënë për FSK-në, si dhe i njoftoi me aktivitet e përgjithshme të cilat po realizohen në kuadër të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Kurse shefi i Shtabit të KDS-së, nënkolonel Fadil Hoxha, përmes një prezantimi të shkurtër pasqyroi të arriturat e përgjithshme të KDS-së, dhe prezantoi projektet për të ardhmen e saj. Ndërsa, zv. komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu shoqëri ekipin e



ODC-s, gjatë vizitave në shkollat e KDS-së, ku nga afër patën mundësi t'i përcjellin trajnimet në të cilat po realizohen aty. Shefi i ODC-s, majori Brian Delvin pas vizitës u shpreh pozitivisht për sukseset dhe të arriturat e KDS-së. "Po shoh një përparim të mirë në KDS dhe rezultate inkurajuese si në fushën e stërvitjes ashtu edhe të përgatitjes së kuadrove" tha majori Delvin. Në fund, gjeneral Cikaqi dhe majori Delvin shprehen gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

KFOR-i italian dhuroi libra për Bibliotekën e FSK-së

Shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore(KFT), kolonel Naim Haziri me bashkëpunëtorë, priti dje (29.06.2017) komandantin e Detashmentit të Përbashkët Rajonal Jug (JRD) Qendër të KFOR-it, kolonel Randacio me rastin e vizitës dhe dorëzimit të një fondi librash për Bibliotekën e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Me këtë rast, koloneli Haziri e falënderoi kolonelin Randacio për kontributin e dhënë si dhe gatishmërinë për kultivimin e një fryme shumë të mirë të bashkëpunimit, ndërsa koloneli italian u shpreh se donacioni i tanishëm i paraprinë një fondi librash që do t'i shtohen Bibliotekës së FSK-së, në të ardhmen po nga KFOR-i italian. Ky donacion librash, në gjuhën angleze, është tregues i një bashkëpunimi me Ekipin Monitorues Ndërlidhës të KFOR-it(LMT) si dhe, donacion paraprijës i një donacioni tjetër të librave i cili pritet të ndodh ditëve në vijim. Bashkëpunimi në mes të gjitha institucioneve si vendore dhe ndërkombëtare kanë krijuar mundësin e pasurimit të bibliotekës së Forcës së Sigurisë të Kosovës. Herë pas here dhurues të shumtë kanë rritur fondin e librave që është një pasuri për të gjithë pjesëtarët e FSK-së.




FSK demonstron aftësi të larta profesionale në ushtrimimet fushore

Mbahet ushtrimi fushor "Evakuimi me Helikopter" në kuadër të Kursit të Avancuar për Lider të FSK-së

Në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit me Brigadën Shumëkombëshe të Lindjes (KFOR-i Amerikan në Kampin Bondsteel), dhe bazuar në planin e stërvitjes, më 14 qershor 2017, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes-Qendrën e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve në Ferizaj, u mbajt ushtrimi fushor; Kursi i Avancuar për Lider të FSK-së. Në këtë ushtrim janë realizuar me sukses temat, si: Procedurat e Udhëheqjes së Trupave, Evakuimi i Viktimave me Helikopter, etj. Pjesa praktike e ushtrimit, Evakuimi i viktimave me helikopter, është realizuar falë bashkëpunimit dhe partnershipit me Kampin Bondsteel, të cilët dhanë mbështetje si në pjesën teorike, ashtu edhe në pjesën praktike, duke ofruar edhe helikopterin për të demonstruar aftësitë e fituara nga pjesëtarët e FSK-së, gjatë ushtrimit. Pjesëtarët e kursit të avancuar për lider, morën njohuri për procedurat dhe veprimet; se si barten viktimat me barela, dhe viktimat të cilat kanë lëndime më të lehta. Ata, këto procedura dhe përvoja nga teoria i realizuan konkretisht në praktikë duke i ngarkuar viktimat në helikopter me ngritje dhe zbritje nga helikopteri, dhe në të njëjtën kohë duke i marrë konsideratat për sigurinë, dhe pasojat që mundë të ndodhin gjatë evakuimit. Pjesëtarët e ushtrisë amerikane, demonstruan lëshimin individual me litar nga helikopteri; për tërheqjen e viktimave nga lartësia-mbi 100 metra me litar. Të kënaqur me realizimin e këtij ushtrimi me sukses u shprehën Rreshter majori i Kampit Bondsteel, JEFFREY SCHUSTER si dhe Rreshter majori i KDS-së, Imri AZEMI, të cilët premtuan vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, në këtë fushë.







Oficerë të Britanisë së Madhe asistojnë në përgatitjen e pjesëtarëve të FSK-së për garën ushtarake "Shqiponja patrulluese 2017"

Vetëm një ditë pasi Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar shënoi 19 vjetorin e Ditës kur Forcat britanike kontribuuan në çlirimin e Prishtinës, nënkoloneli i Britanisë Gregor Lindsay, këshilltar ushtarak i Komandantit të FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Ramës, iu bashkua ekipit të ushtarëve nga Komanda e Forcës Tokësore të FSK-së, për një sesion trajnimi fizik në Parkun e Gërmisë. Këta ushtarë përbëjnë një nga tetë ekipet e FSK-së, që do të konkurrojnë në Garën "Shqiponja Patrulluese" e cila garë do të mbahet këtë vjeshtë. Ushtrimi me të cilin po planifikohet nga një grup i oficerëve të rinj të FSK-së, me një asistencë të vogël nga ushtria e Britanisë do të testojë aftësitë kyçe, gjatë këtyre ushtrimeve: taktika të operimit të njësive të vogla, përgatitja fizike, navigimi tokësor, ndihma e parë, etj.



Kadetët e FSK-së demonstruan shkathtësitë e tyre në ushtrimin fushor "Kampi veror 2017"


Një numër i madh i vizitorëve sot (14.06.2017) përcollën kadetët e Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjatë realizmit të ushtrimit fushor "Kampi veror 2017" mbajtur në fshatin malor Zhegoc të Komunës së Gjilanit. Fillimisht komandanti i QSU-së, majori Avni Kiqina, i njoftoi të pranishmit me programin e ushtrimit fushor të cilin kadetët e FSK-së, po e realizojnë në "Kampin Veror 2017". Ushtrim Fushor "Kampi veror 2017" ka filluar së realizuari më 5 qershor dhe pritet të përfundojë me 18 qershor 2017, në të cilin ushtrim janë të përfshirë të gjithë kadetët e QSU-së, të cilët kanë rastin që të dëshmojnë dhe të vlerësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e fituara si në aspektin individual po ashtu edhe në atë ekiporë. Për të përcjellë nga afër demonstrimin e kadetëve të QSU-së, të pranishëm ishin: zëvendës ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Muhamet Latifi, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) gjeneral brigade Enver Cikaqi, zëvendësdrejtori i NALT -it (Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s Mark Theobald, atasheu ushtarak i SHBA-ve Xhefri Fisher, komandanti i Kampit Bondstill, koloneli Korvin Lusk, si dhe oficerë të lartë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe këshilltarë ushtarak të NALT-it dhe kampit Bondstill të ushtrisë së SHBA-ve. I kënaqur nga bashkëpunimi dhe realizmi i këtij ushtrimi u shprehë zëvendës ministri i MFSK-së, z. Muhamet Latifi i cili pos tjerash tha: "Ky ishte një ushtrim vlerësues për kadetët e vitit të katërt, të cilët e kanë edhe aktivitet vlerësimi dhe testimi për atë çka kanë mësuar për katër vite. Na gëzon fakti se këtë testim të gjithë kadetët e kanë kaluar me vlerësim të shkëlqyeshëm. Ky nivel i përgatitjes së FSK-së është dëshmuar edhe në të gjitha pjesëmarrjet dhe garat ndërkombëtare ku kadetët e FSK-së kanë zënë vendet e para. Këto ditë ka përfunduar edhe konkursi për rekrutimin e kadetëve të rinj, dhe ka pasur një numër të madh të aplikuesve, gjë që tregon se vullneti dhe dëshira e rinisë së Kosovës për të bërë karrierë në FSK është i madh". Ndërsa, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, duke vlerësuar lartë ushtrimin fushor, ndër të tjera tha: "Ky ushtrim vjetor ka për qëllim dhe është mundësi që secili kadetë të vlerësohet veç e veç në shumë fusha të trajnimit dhe më i rëndësishëm është që të vihen në dukje dhe të vlerësohen në praktikë aftësitë e lidershipit të kadetëve që kanë mësuar dhe zbatimi i tyre në kushtet e terrenit". Kurse komandanti i Kampit Bonsdteell, koloneli Korvin Lusk, për ushtrimin tha: "Kjo që pamë ishte një ushtrim i përgatitur mirë, ishte një demonstrim i mirë i kadetëve për lidership të fortë". Gjatë këtyre 15 ditëve të qëndrimit të kadetëve në terren, instruktorët dhe udhëheqësit e tyre patën mundësi që të bëjnë vlerësimin e aftësive taktike të kadetëve në planifikim, përgatitje dhe ekzekutim të operacioneve luftarake, ndërsa kadetët patën mundësinë të praktikojnë në terren operacione luftarake të mësuara gjatë studimeve. "Kampi veror 2017" u realizua në bazë të planit vjetor të Qendrës së Studimeve Universitare për kamping dhe realizimin e të gjitha ushtrimeve të përbashkëta me të gjithë kadetët e QSU-së.



BRSH realizoi ushtrimin Fushor "Ujku Vigjilent-2"

Kompania 2/A e Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) ka realizuar trajnimin e brendshëm ,Gjenerimi i Forcës, me kohëzgjatje prej tre muajsh, nga data 10 prill 2017 e deri më 21 qershor 2017. Si përmbledhje e të gjitha fazave të trajnimit tre-mujor Kompania 2/A, ka përfunduar trajnim me realizimin e ushtrimit Fushor 48 orësh të koduar "UJKU VIGJILENT- 2" në Deçan dhe fshatrat Lumbardhë, Llukë, etj. Ushtrimi fushor është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Dytë dhe është ekzekutuar nga Kompania 2/A në bazë të (PUT) Procedurës së Udhëheqjes së Trupave, me qëllim të vlerësimit të njohurive dhe shkathtësive të fituara gjatë periudhës tremujore të trajnimit. Në këtë ushtrim përveç pjesëtarëve të Kompanisë 2/A mbështetje e ushtrimit fushor kanë qenë edhe njësitë tjera të FSK-së, Njësia e Ndërlidhjes për Reagim në Kriza (NJNRK), Regjimenti i Mbrojtjes Civile (RMC) dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS). Po ashtu gjatë realizimi të ushtrimit fushor janë angazhuar dhe institucionet civile të komunës së Deçanit,Drejtoria për Emergjenca dhe Shpëtim, Policia e Kosovës, Kryqi Kuq i Kosovës, Agjencia për Emergjenca Civile, Shtëpia e shëndetit dhe Zjarrfikësit. Incidenti i improvizuar ka ndodhur më 19 qershor dhe së pari kanë intervenuar institucionet civile të komunës së Deçanit, si; Zjarrfikësit, Qendra emergjente shëndetësore në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe Policinë e Kosovës që kanë bërë perimetrin e sigurisë. Ushtrimin fushor e kanë përcjellë nga afër komandanti i BRSH-së, koloneli Xhevahir Geci, komandanti i Batalionit të Dytë, nënkolonel Mehmet Lladrovci, kryetari i Komunës së Deçanit, Rasim Selmanaj dhe ekipet vlerësuese të Batalionit të Dytë, KDS-së dhe BRSH-së. Gjatë realizimit të këtij ushtrimi i cili u realizua në bazë të planit vjetor të trajnimit dhe aktiviteteve të Batalionit të Dytë, ku pjesëtarët e FSK-së dëshmuan edhe njëherë se janë të përgatitur profesionalisht në Planifikim dhe operacionet ushtarake siç janë: Ushtrimet fushore, Stërvitjet e betejave, Lëvizjet taktike individuale, Procedurat e udhëheqjes së trupave, Okupimi i bazës patrulluese, Hyrje në patrullim, Operacione urbane, Pika të kontrollit, patrullimi me Blinda dhe fusha tjera.





FSK-ja në operacionin për kërkimin e trupit të personit të zhytur në lumin Drini i Bardhë tek Ura e Shenjtë

Ekipet e Kërkim Shpëtimit (KSH) në Ujëra të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK) që nga dita e djeshme, pra nga 27.06.2017 janë angazhuar dhe po vazhdojnë kërkimet me njësit e zhytësve për gjetjen trupit të personit(S.G), i cili sipas Policisë së Kosovës ka kërcyer në lumë nga Ura e Shenjtë dhe nuk ka arritur të dalë nga aty. Në kërkim janë angazhuar 18 pjesëtarë të Kërkim -Shpëtimit (zhytësit), dhe se operacioni po zhvillohet edhe në bashkëpunim me Policinë e shtetit, Komunën e Gjakovës drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim. Kërkimet ishin ndërprerë mbrëmë në orët e mbrëmjes dhe kanë filluar sot në mëngjes përsëri për të vazhduar më tutje deri në gjetjen e trupit të personit që dyshohet se ndodhet në thellësitë e lumit.

Me urdhër të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovë, gjenerallejtënant Rrahman Rama,

Pensionohet koloneli i FSK-së Bedri Zeqiri



Me një ceremoni të organizuar nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, më 30 qershor 2017, u bë përcjellja në pension e kolonelit Bedri Zeqiri. Kjo ditë për kolonel Zeqirin u bë më e veçantë, ku me emocionale dhe me nderime të larta, në prani të oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve, shokëve dhe familjarëve, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i dorëzoi kolonel Bedri Zeqirit, gradën e nderit ,Gjeneral brigade, në pension. Koloneli Bedri Zeqiri u përshëndet me detyrën e oficerit aktiv duke falënderuar të gjithë kolegët dhe bashkëpunëtorët për bashkëpunim dhe mbështetjen gjatë gjithë kohës së shërbimit. Me këtë rast,Ai kujtoi disa ngjarje nga jeta në uniformë të përshkruara me emocione që kishin të bënin me sfidat dhe me vështirësitë gjatë karrierës ushtarake. Komandanti i KDS-së, gjenerali Enver Cikaqi e dekoroi me "Medaljen e shërbimit" duke i dhënë gradën e nderit-Gjeneral brigade-Bedri Zeqirit, për kontributin e dhënë gjatë kohës së lutës çlirimtare dhe kontributin e dhënë në ndërtimin e institucioneve të sigurisë në shërbim të shtetit dhe qytetarëve. Gjeneral Cikaqi tha se, "Gjenerali në pension Bedri Zeqiri duhet të merret si shembull se si duhet për t'i shërbyer atdheut. Ti shërbesh atdheut është nder dhe përgjegjësi, por Bedriu kishte forcën, guximin dhe vullnetin për të bërë një gjë të tillë në çdo kohë. Ai në të mirë të vendit shërbeu si pjesëtarë i UÇK-së, TMK-së dhe FSK-së". Gjenerali në pension Bedri Zeqiri shërbeu plotë 40 vjet në uniformën e ushtarakut dhe pikërisht në dyzetvjetorin e fillimit të karrierës ushtarake, mori gradën e nderit gjeneral dhe u pensionua si epror i lartë i FSK-së.

Ministri Haki Demolli mirënjohje për këshilltaren Amerikane Jessica Olcot



Ministri i FSK, zoti Haki Demolli, e priti sot në takim lamtumirës, znj. Jessica D. Olcot, këshilltare amerikane e cila punoi për një vit në Departamentin për Politika dhe Plane në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në bazë të një marrëveshje të mirëkuptimit në mes Ambasadës së SHBA-ve dhe Ministrisë për FSK-në, përfituar nga programi prestigjioz i SHBA-ve-Fulbright Clinton. Në takim ishte i pranishëm edhe Faruk Geci-drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane. Ministri Haki Demolli pasi e falënderoi znj. Olcot për angazhimin dhe kontributin e saj të dhënë në kuadër të MFSK-së, për bashkëpunimin e saj me të gjitha departamentet dhe në veçanti për punën e palodhur në Drejtorinë për Politika dhe Plane, në të cilin ka shërbyer gjatë këtyre muajve. Ministri Demolli, zonjës Jessica Olcott i dha mirënjohje me motivacionin; "Për punën e palodhshme, përkushtimin në afrimin e këshillave profesionale për MFSK/FSK-në". Ndërkaq, znj. Jessica Olcot shprehu falënderimin e saj, për ministrin Demolli dhe stafin e lartë të Ministrisë dhe FSK-së dhe bashkëpunëtorëve tjerë, me të cilët për një vit punoi së bashku.

Pjesëtarë të FSK-së certifikohen në kursin e gjuhës Turke



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, sot (15.06.2017) u organizua ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët përfunduan kursin e gjuhës Turke. Në këtë ceremoni prezent ishin: komandant i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, zëvendës komandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu, këshilltari i Ekipit Ndërlidhës të NATO-s, nga radhët e ushtrisë Turke, kolonel Seyfi Altikanoglu si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe të ushtrisë turke që shërbejnë në Kosovë. Me këtë rast, gjeneral Cikaqi, në fjalën e tij tha, se: "gjuha është një mjet komunikimi ndërmjet njerëzve dhe është shumë e rëndësishme për pjesëtarët tanë, të cilët po kryejnë trajnime të ndryshme në Turqi. Në KDS krahas gjuhës angleze mësohet edhe gjuha turke, dhe kësisoj mendojmë që të hapim kurse edhe për gjuhë të tjera në të ardhmen. Ushtria turke ka ndihmuar në trajnime të ndryshme si në KDS-së ashtu edhe në trajnime që ka ofruar në shkollat dhe akademitë e Turqisë, për çka ne jemi mirënjohës dhe falënderojmë kolegët tanë dhe shtetin turk për kontributin e dhënë në angazhimin për ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së". Kursi i gjuhës turke ka filluar më 19 shtator 2016 dhe ka përfunduar më 15 qershor 2017, ku është mbajtur niveli bazik i gjuhës turke dhe të cilin e kanë ndjekur 16 pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së. Ndërsa përfaqësuesi i NALT-it, nga ushtria Turke, koloneli Seyfi Altikanoglu, tha se "bashkëpunimi mes FSK-së dhe ushtrisë turke ka qenë dhe do të mbetet i fuqishëm, ndërsa mësimi i gjuhës turke nga pjesëtarët e FSK-së, do të jetë edhe një mundësi më shumë që ne të ndihmojmë me trajnime për pjesëtarët tuaj. Jam krenar që gjendem para jush sot, dhe po shoh se rezultatet e kursit janë të larta dhe kjo më bënë të besoj se keni punuar shumë për të arritur këto rezultate". Në fund, gjenerali Enver Cikaqi falënderoi pjesëtarët e ushtrisë turke që në vazhdimësi kanë kontribuar në zhvillimin e forcës, ndërsa për instruktorin e gjuhës Turke Togerit Mustafa Tokdemir i ndau mirënjohje në shenjë falënderimi për punën dhe angazhimin e tij gjatë kësaj periudhe.

FSK-ja ndihmon Stacionin e Zjarrfikësve në Dragash

Njësia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza (NNJRK) e Forcës së Sigurisë të Kosovës në vazhdën e aktiviteteve të shumta që po zhvillon në ndihmë komuniteteve kudo në Kosovë, ditë më parë ka realizuar një trajnim tre-ditorë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane(EBCU), për të ndihmuar komunitetin në Komunën e Dragashit. Gjithashtu pjesëtarët e NNJRK-së, për Stacionin e zjarrfikësve të kësaj komune, kanë dhuruar një donacion simbolikë, një çantë të ndihmës së parë me të gjitha elementet e nevojshme dhe e cila do t`u shërbej këtyre pjesëtarëve në raste reale të intervenimit dhe shpëtimit të jetëve të qytetarëve. Po ashtu, pjesëtarët e NNJRK-së në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane kanë realizuar edhe një trajnim një ditorë për zjarrfikësit e Dragashit, për të mësuar mënyrën e përdorimit të këtyre pajisjeve në raste emergjente.

Certifikohen pjesëtarët e FSK-së për Drejtues-Mirëmbajtje dhe Manovrim Taktik me Autoblinda "Kobra"



Në Brigadën për Reagim të Shpejtë të Kazermës ,,Ushtarët e NATO-s" në Istog, më 09.06.2017, u mbajt ceremonia e certifikimit të 27 pjesëtarëve, pas përfundimit të trajnimit për ,Shofer, Mirëmbajtje dhe Manovrim Taktik me Autoblinda Kobra,. Në ceremoni të pranishëm ishin zëvendës komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ushtruesi i detyrës së komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, kolonel Devrim GÜCÜYENER- këshilltar në MFSK, shefi i Shtabit të BRSH-së, nënkolonel Ejup Maqedonci, komandantët e batalioneve, oficerë dhe nënoficerë të Shtabit të BRSH-së dhe ushtrisë turke. Të pranishmëve ju drejtua koloneli Xhevahir Geci, i cili me këtë rast, tha: "Trajnimi për Shofer, Mirëmbajtje dhe Manovrim Taktik me autoblinda Kobra është ndër trajnimet më të rëndësishme për brigadën tonë, sidomos kur kemi parasysh që autoblindat janë pjesë e resurseve të BRSH-së, që do të shfrytëzohen tani por dhe në të ardhmen për zhvillimin e operacioneve dhe zbatimin e misionit tonë. Vitin e kaluar së bashku me ekipet trajnuese turke planifikuam dhe realizuam për herë të parë këtë lloj trajnimi të veçantë për njësinë tonë. Trajnimi u realizua në tri batalionet dhe rezultoi i suksesshëm si rezultat i interesimit të pjesëtarëve tanë e veçanërisht i angazhimit dhe vullnetit të sinqertë të instruktorëve të Ushtrisë Turke, për të shpërndarë njohuritë me pjesëtarët dhe njësitë tona. Ky trajnim për herë të parë këtë vit u realizua nga instruktorët e BRSH-së, duke dëshmuar se janë të aftë të marrim përgjegjësitë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e njësive në këtë lëmi". Po ashtu të pranishmëve ju drejtua edhe koloneli Devrim GÜCÜYENER, i cili tha: "fakti që ne me instruktorët tanë kemi qenë vetëm monitorues në ketë trajnim, tregon se sa shumë kanë arritur të profesionalizohen pjesëtarët e FSK-së, nga informata që kam pranuar, instruktorët e FSK-së, kanë treguar nivel të lartë të profesionalizmit, për këtë edhe ne jemi shumë të kënaqur që bashkëpunimi mes FSK-së dhe ushtrisë Turke, do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Në fjalën e tij, gjenerali Gëzim Hazrolli theksoi se; "Fillimisht trajnimet për autoblinda i kemi realizuar me instruktorë të ushtrisë Turke, tani me instruktorë tonë kemi arritur të realizojmë trajnimin për "Shofer, Mirëmbajtje dhe Manovrim Taktik me Autoblinda Kobra", kjo është një arritje e madhe për FSK-në, sepse tani kemi ngritur kapacitetet tona, por këto kapacitete tentoni të i mirëmbani dhe avanconi. Jam shumë i sigurt që tani autoblindat do të mirëmbahen në mënyrë profesionale, me këtë rast dua të i falënderojë dhe shprehë mirënjohje për instruktorët e ekipit trajnuese Turke, e veçanërisht instruktorët e FSK-së, për të arritурat e treguara gjatë realizimit të këtij trajnimi. Trajnimi "Shofer, Mirëmbajtje dhe Manovrim Taktik me Autoblinda Kobra" ka filluar më 29.05.2017 dhe ka përfunduar me 09.06.2017, në këtë trajnim kanë marrë pjesë 27 pjesëtarë. Për mbarëvajtjen e trajnimit të pranishmëve ju drejtua toger Kreshnik Zeneli, ku theksoi se: "Pjesëtarët jenë trajnuar në tri disiplina: Shofer, Mekanik-Mirëmbajtës, si dhe Përdorim Taktik të Autoblindave në situata emergjente. Trajnimi ka përfunduar me Ushtrim Fushor-24orësh në terren, ku shoferët e rijnë kanë drejtuar autoblindat sipas skenarit, skuadrat që janë trajnuar për lëvizje taktike kanë vepruar sipas situatës, si dhe mekaniket kanë demonstruar riparimet e KOBRA-s në terren. Pas përfundimit të UF-së, pjesëtaret i janë nënshtruan testimit dhe tani kanë të drejtë të drejtojnë autoblindat si dhe të kryejnë mirëmbajtje të autoblindave, të nivelit të parë".

Nxënësit pjesëmarrës në "Kampin Rinor 2017" në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, u mbajt sot (12.06.2017) ceremonia e certifikimit të nxënësve të shkollave të mesme të Kosovës të cilët morën pjesë, për një javë, në "Kampin Rinor 2017".Në këtë ceremoni i pranishëm ishte edhe komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi i cili në fjalën e tij përshëndetëse tha, se vërehet një ndryshim i madh prej ditës së parë të ardhjes e deri më sot tek nxënësit që po e përfundojnë "Kampin veror 2017", si në dukjen personale po ashtu edhe në disiplinë dhe njohuri për jetën ushtarake, dhe kjo më bën të lumtur që po i shoh këta djem dhe vajza të cilët po i ngjajnë ushtarëve të FSK-së. Qëllimi i organizimit të Kampit Rinor është që nxënësit për një javë të mësojnë nga jeta ushtarake dhe të familjarizohen me uniformën dhe jetën e pjesëtarëve të FSK-së. Gjatë qëndrimit në KDS, ata kanë mbajtur ligjërata nga tema të ndryshme si: Zgjimi dhe rregullimi i shtretërve, gjimnastika e mëngjesit dhe higjiena personale, UÇK, TMK-transformimi, orientimi në natyrë, mësimi i komandave, Misioni detyrat dhe strukturat e FSK-së, vetëdijesimi nga minat, kërkim-shpëtimi, dhe u organizua një program me aktivitete të ndryshme sportive. Ky aktivitet i cili tashmë është bërë tradicional, ka filluar më 5 qershor dhe ka përfunduar më 9 qershor, ndërsa kanë marrë pjesë 106 nxënës nga shkolla të ndryshme të Kosovës. Kampi rinor është realizuar në organizimin të Departamentit për Bashkëpunim Civilo Ushtarak (BCU) të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Pjesëtarë e "Handicap KOSOVA" vizituan Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj





Zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Irfete Spahiu së bashku me stafin e KDS-së, me rastin e Ditës së Çlirimit-12 qershorit, pritën në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) ekipin e Organizatës Joqeveritare "Handicap Kosova". Kolonel Spahiu, fillimisht i dëshiroi mirëseardhje ekipit "Handicap Kosova" në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, ku tha se; "KDS është një institucion edukativo-arsimor, në të cilën kryhen stërvitjet të të gjitha niveleve për ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FSK-së. Në kuadër të KDS-së, realizojmë misionin tonë, duke ofruar trajnime për pjesëtarët e FSK-së, me qëllim që t'i përgatisim sa më mirë, që të jenë të gatshëm për të qenë në shërbim të qytetarëve të Kosovës" tha në fund kolonel Spahiu. Ndërsa, Ylber Selmani-përgjegjës i "Handicap Kosova" tha se ndjehet shumë i lumtur që sot gjendet në kazermën e FSK-së, me ekipin e OJQ "Handikap KOSOVA. Është një emocion i veçantë kur vizitojmë kazermën e KDS-së, në ditën e Paqes, por edhe kur shohim ushtarët tanë në uniforma, kjo na e shton edhe më tepër ndjenjën e gëzimit për ne". Ai falënderoi kolonel Spahiun për pritjen dhe vizitën në ambientet e KDS-së. Në fund, pas vizitave në shkollat e KDS-së, u organizua edhe një drekë e përbashkët me ekipin e OJQ "Handicap KOSOVA" dhe oficerëve e nënoficerëve të KDS-së.

Atletikë

Pjesëtari i FSK-së Granit Kryeziu i pari në garën e organizuar nga KFOR-i



Të shtunën (05.06.2017) në Fshatin e Ri (Novosellë) Komuna e Vushtrrisë, nën patronatin e komandantit të KFOR-it, gjeneral majorit Giovanni FUNGO, u mbajt vrapimi humanitar në shtegun 5 mijë metra. Në këtë vrapim përveç përfaqësuesve të KFOR-it morën pjesë edhe 7 pjesëtarë të FSK-së. Hapjen zyrtare të garës e bëri komandanti i KFOR-it, gjeneral majori Giovanni Fungo, i cili falënderoi pjesëtarët e FSK-së, për përkrahjen dhe pjesëmarrjen e tyre në këtë vrapim humanitar. Pas fjalës së komandantit të KFOR-it, filloi vrapimi humanitar. Në një konkurrencë të fortë, vendin e parë e zuri Granit Kryeziu, pjesëtar i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) të FSK-së, i cili fitoi medaljen e artë, të cilën personalisht ia dhuroi komandanti i KFOR-it, gjenerali Giovanni Fungo. Granit Kryeziu pasi falënderoi komandantin e KFOR-it, për medaljen e arit u shpreh: "Vendi i parë dhe medalja e artë janë sukses jo vetëm i imi, por në përgjithësi sukses i FSK-së, me çka po dëshmohet çdo ditë e më tepër se pjesëtarët e FSK-së, janë të përgatitur sipas standardeve të NATO-s". Gjithashtu edhe pjesëtarët tjerë të FSK-së, të cilët morën pjesë në vrapimin humanitar në 5 mijë metra, treguan përgatitje të lartë fizike. Qëllimi i organizimit të kësaj gare ishte tërësisht me karakter humanitar, ku të gjitha mjetet e grumbulluara do t'ju shpërndahen familjeve në nevojë të kësaj ane.

BRSH realizoi me sukses ushtrimin fushor 'Ujku - 17'



Kompania 3A e Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) më 30 qershor ka realizuar ushtrimin fushor 48 orësh të koduar "Ujku-17". Në këtë ushtrim përveç pjesëtarëve të Kompanisë 3A, mbështetje ushtrimit fushor i kanë dhënë edhe njësitë tjera të FSK-së, si: Njësia e Reagimit në Kriza (NJNRK), Regjimenti i Mbrojtjes Civile (RMC) dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS). Gjatë realizimi të ushtrimit fushor janë angazhuar dhe institucionet civile të komunës së Drenasit; Drejtoria për Emergjenca dhe Shpëtim, Policia e Kosovës, Kryqi Kuq i Kosovës, Agjencioni për Emergjenca Civile, Shtëpia e shëndetit, Zjarrfikësit dhe kompania biznesore e Feronikelit. Gjatë këtij ushtrimi janë improvizuar gjithsej 17 skenar të ndryshëm, ku nuk ka munguar mbështetja e Ushtrisë Amerikanë gjatë tërheqjes së trupave me helikopter. Në ditën përfundimtare të këtij ushtrimi, për të përcjellë nga afër realizimin e ushtrimit të pranishëm ishin; gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, shef i Departamentit për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Dietmar Mosmann, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore kolonel Naim Haziri, zëvendëskomandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë kolonel Xhevahir Geci, komandanti i Batalionit të Tretë nënkolonel Sylejman Caka, komandanti i NJNRK-së, nënkolonel Milaim Musliu, kryetari i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci dhe ekipet vlerësuese të Batalionit të Tretë, KDS-së dhe BRSH-së.Në kampin e ndërtuar në Poklek të Drenasit, në zonën e përgjegjësisë së Batalionit të Tretë, para të pranishmeve u mbajt një prezantim ku njoftuan mbi situatën e krijuar gjatë këtyre 48 orëve, për të vazhduar më pas në vend incident në Feronikel, për të përcjellë nga afër intervenimet që ndodhën gjatë këtij ushtrimi. Pas përfundimit të këtij ushtrimi para të pranishmëve dhe mediave për rëndësinë e ushtrimit dhe të bashkëpunimit komunal, foli kolonel Naim Haziri i cili tha: "Sot po përmbyllim një cikël planifikimi për realizim të një ushtrimi fushor të përbashkët me agjensionet e nivelit komunal dhe ato të nivelit qendror duke përfshi FSK-në dhe KFOR-in, duke marrë parasysh që çështja kryesore është bashkëpunimi me agjensione për të reaguar në situata emergjente, për këtë shkak është parë e arsyeshme dhe e domosdoshme që ushtrimet fushore të FSK-së të realizohen bashkërisht me komunatveç e veç".I kënaqur nga realizimi i ushtrimit u shpreh edhe gjenerali Dietmar Mosmann, ku shtoi se, "Ne e mbështesim dhe e asistojmë FSK-në. Ajo duhet të vazhdojë me ushtrime të tilla pasi pjesëtarët e FSK-së, janë të përgatitur në kryerjen e detyrave të tilla siç e pamë edhe sot".Ndërsa kryetari i kësaj komune, z. Ramiz Lladrovci u shpreh i kënaqur nga bashkëpunimi dhe realizimi i këtij ushtrimi fushor duke deklaruar se, "Si kryetar komune jam mjaft i kënaqur me këtë ushtrim dhe e falënderoj shumë FSK-në dhe KFOR-in dhe akteret tjerë që kanë qenë pjesëmarrës në këtë ushtrim dhe sidomos menaxhmentin e Feronikelit". Gjatë realizimit të këtij ushtrimi i cili u realizua në bazë të planit vjetor të trajnimit dhe aktiviteteve të Batalionit të Dytë, pjesëtarët e FSK-së, dëshmuan edhe njëherë se janë të përgatitur profesionalisht në planifikim dhe realizimin e operacioneve ushtarake. Ushtrimi fushor është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Tretë dhe është ekzekutuar nga Kompania 3A në bazë të Procedurës së Udhëheqjes së Trupave, me qëllim të ngritjes profesionale dhe taktike të oficerëve dhe nënoficerëve dhe ndërveprushmerisë me njësitë operacionale të FSK-së dhe agjensioneve civile.



FSK-ja ndihmon Qendrën e Mjekësisë Familjare të fshatit Plemetin



Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më datë 05 qershor 2017, ka realizuar një projekt humanitar; duke dhuruar materiale të nevojshme mjekësore për Qendrën e Mjekësisë Familjare të fshatit Plemetin të Komunës së Obiliqit, e cila kujdeset dhe ofron shërbime mjekësore për banorët e shumë fshatrave të banuara edhe me serbë, romë, ashkali dhe të tjerë. Në emër të FSK-së, donacionin e dhuroi nënkoloneli Afrim Veseli dhe e pranoi drejtori i kësaj qendre Dr.Slavisha Radosavljeviq. Këtë aktivitet të FSK-së, e përkrahi drejtori i QKMF në Obiliq, zoti Haki Jashari i cili ndihmën e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) dhënë kësaj qendre, e cilësoi si shumë të vlefshme për qytetarët e kësaj ane.

Ndërsa, nënkoloneli Veseli, gjatë fjalës së tij,theksoi se FSK-ja është në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit dhe se gjithmonë do t'i mbështesë me të gjitha format të gjithë pjesëtarët e komuniteteve në Kosovë.

FORCA JONË

* * * Viti VI • Nr. 60 • Gusht 2017 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Komandanti i FSK-së priti Komandantin Suprem të Forcave Aleate për Evropë



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti sot (21.07.2017) në Ministri, Komandantin Suprem të Forcave Aleate për Evropë, njëherësh edhe Komandant i Komandës së SHBA-ve për Evropë, gjeneralin Curtis M. Scaparrottii cili shoqërohej nga komandanti i KFOR-it, gjeneral majori Giovanni Fungo. Gjenerali Scaparrotti u prit me ceremoni solemne nga Togu Ceremonial dhe Orkestra frymore e FSK-së e cila edhe ekzekutoi, për herë të parë, Himnin e NATO-s, si dhe Himnin e Republikës së Kosovës.Në takimin e përbashkët të gjeneral Ramës dhe gjeneralit Scaparrotti, u bisedua për çështjet e sigurisë në Republikën e Kosovës, në rajon dhe më gjerë, gjithashtu u bisedua edhe për profesionalizimin e institucioneve të sigurisë të vendit tonë, si dhe për zhvillimin dhe avancimin e marrëdhënieve të FSK-së me KFOR-in dhe NATO-n, në përgjithësi.Në këtë takim, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e falënderoi komandantin Suprem të Forcave Aleate për angazhimin e NATO-s nëpërmjet KFOR-it, në ruajtjen e paqes dhe garantimin e sigurisë në Kosovë, e gjithashtu edhe për rolin e NATO-s, nëpërmjet Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për këshillimin dhe zhvillimin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjithashtu e njoftoi gjeneralin Scaparrotti, për zhvillimin dhe profesionalizmin e FSK-së, kapacitetet ekzistuese dhe gatishmërinë operacionale të sajë, si dhe për planet e udhëheqësve të MFSK/FSK dhe institucioneve më të larta të vendit për avancimin e misionit dhe detyrave, pra në përgjithësi, për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.Gjeneral Rama siguroi gjeneralin Scaparriotti se FSK-ja është e gatshme të filloi procesin e transformimit menjëherë pasi të merret vendimi politik. Njëkohësisht, gjeneral Rama i shprehu gjeneral Scaparriottit gatishmërinë e FSK-së që me kapacitetet ekzistuese po edhe ato të ardhshme të jetë garantuese e paqes në vend si dhe të kontribuojë dhe të jetë krah për krah me partnerët në misione jashtë vendit.Nga ana e tij, komandanti Suprem i Forcave Aleate të NATO-s për Evropë, gjeneral Curtis Scaparrotti shprehu përgëzime për lidershipin, profesionalizimin si dhe bashkëpunimin e mirë që FSK-ja ka me KFOR-in, për angazhimet e saj, në të mirë të komunitetit dhe zhvillimit të Kosovës në përgjithësi duke premtuar përkrahjen e NATO-s për ushtrimet fushore dhe stërvitjet e përbashkëta, trajnime dhe operacione si dhe shkollim profesional të pjesëtarëve të FSK-së.Gjenerali amerikan shprehu përkushtimin e NATO-s, për paqen dhe sigurinë në Kosovë e rajon, dhe se paqja, siguria dhe prosperiteti janë edhe në interes të NATO-s, dhe vendeve anëtare të saj e më gjerë.
Në takim me gjeneralin amerikan ishin edhe Sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj, drejtori për operacione gjeneral brigade Zymer Halimi, zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe asistenti ushtarak i KOMFSK, major Berat Shala.

Gjeneral Enver Cikaqi nderohet me medalje nga guvernatori i Ohajos



Në mjediset e kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, më 18 korrik 2017, komandanti i Grupit Shumëkombësh Luftarak të Lindjes (GSHL) koloneli amerikan Corvin Lusk, i dha medalje gjeneralit Enver Cikaqi të dedikuar nga guvernatori i Ohajos të SHBA-së. Me këtë rast, koloneli amerikan Lusk, falënderoi gjeneralin Cikaqi për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm si dhe për qasjen konstruktive, duke theksuar rëndësinë e udhëheqjes në zhvillimin profesional të stafit të KDS-së dhe të FSK-së.Ai i dorëzoi gjeneralit Enver Cikaqi, "Medaljen e Lavdërimit të OHIO-s" të dhënë nga guvernatori i shtetit të Ohajos të SHBA-ve, në shenjë njohje të udhëheqjes dhe profesionalizimit të treguar gjatë punës së tij.Në medalje shkruan: "Për shërbim meritor gjatë udhëheqjes si komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Forcën e Sigurisë të Kosovës". "Gjeneral brigade Enver Cikaqi shfaqi lidershipin dhe profesionalizmin duke e vendosur gjithnjë misionin dhe mirëqenien e ushtarëve mbi të tijën. Performanca e tij gjatë kryerjes së detyrave dinamike e dalloi në mënyrë të jashtëzakonshme. Përpjekjet e tij treguan këmbëngulje përballë vështirësive, të cilat pasqyrojnë një kredi të madhe ndaj vetës, Forcës së Sigurisë të Kosovës, Grupit Shumëkombësh Luftarak të Lindjes dhe Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës".Gjenerali Enver Cikaqi ka falënderuar kolonelin amerikan Corvin Lusk, guvernatorin e Ohajos dhe SHBA-të, për medaljen dhe ndihmën e vazhdueshme që kanë dhënë dhe po japin për FSK-në, dhe njëherësh theksoi bashkëpunimin e veçantë ndërmjet stafit të Grupit Shumëkombësh të Lindjes dhe të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, bashkëpunim i cili rezultoi me shumë aktivitete të përbashkëta; trajnime për stafin e KDS-së, si dhe asistencë me instruktorë në kurse të ndryshme të mbajtura në KDS-së dhe në kampin Bondstell.

Nëntogeri Idrizi 'Studenti më i mirë ndërkombëtar' në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore të Mbretërisë së Bashkuar

Sot, (20.07.2017)në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore në Cranëell të Mbretërisë së Bashkuar u mbajt ceremonia e diplomimit të kadetëve-oficerëve, që për 7 muaj vijuan studimet ushtarake në këtë kolegj. Pjesë e Kolegjit Mbretëror të Forcave Ajrore në Cranwell ishin edhe dy pjesëtarë të Forcës së Sigurisë të Kosovës; nëntoger Rilind Idrizi dhe tetari Feti Pronaj. Nëntogeri Rilind Idrizi ka treguar performancë të jashtëzakonshme në fushën e studimeve ushtarake, akademike dhe praktike, dhe si rezultat i këtyre arritjeve ka marr çmimin e studentit më të mirë ndërkombëtar. Nëntogeri Idrizi, këtë çmim e ka pranuar nga oficeri komandues i këtij kolegji-Marshall Steve Rochell. Në këtë ceremoni i pranishëm ishte edhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, pas përfundimit të ceremonisë së diplomimit, tha: "Jam shumë i kënaqur me performancën e dy pjesëtarëve tanë, nëntoger Idrizit dhe tetar Pronajt, si pjesëtarët e parë që diplomuan në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore. Ata kanë demonstruar standarde të larta gjatë studimeve të tyre në këtë kolegj. Si komandant i Forcës së Sigurisë të Kosovës jam shumë i kënaqur me çmimin që nëntogeri Rilind Idrizi e ka fituar si rezultat të paraqitjes së jashtëzakonshme të tij, por njëkohësisht jam i kënaqur edhe me tetarin Feti Pronaj, si nënoficer i parë, që me sukses ka përfunduar studimet në këtë kolegj të Mbretërisë së Bashkuar. Suksesi i kadetëve dhe oficerëve tanë në Akademitë më prestigjioze në Botë, është edhe një dëshmi se FSK-ja po ndërtohet me standardet më të larta profesionale të nivelit të shteteve të NATO-s" tha në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama. Në Akademinë Mbretërore Sandhurst dhe në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore të Mbretërisë se Bashkuar, deri më tani, kanë diplomuar me sukses 17 kadetë të FSK-së, duke përfshirë edhe 3-tri kadete.



Komandanti i FSK-së viziton pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit në terren

Kompania e Deminimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që nga muaji prill, atëherë edhe kur fillon sezoni i deminimit, çdo ditë janë duke pastruar zona të minuara nëpër territore të ndryshme të Republikës së Kosovës. Pjesëtarët e kësaj kompanie, këto ditë janë duke i pastruar fushat e minuara në zonën e "Parkut të Lirisë" në Ferizaj dhe në "Han të Elezit". Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me shefin e Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonelin Naim Haziri, zv. komandantin e Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) kolonelin AvdiRaci dhe komandantin e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) kolonelin Shaip Haziri, vizituan deminerët gjatë punës së tyre, për t'u njohur nga afër me angazhimin dhe vështirësitë e mundshme që mund t'ju dalin




gjatë punës. Gjatë kësaj vizite, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama u prit nga komandanti i Kompanisë së Deminimit, kapiteni Sejdi Krasniqi, i cili e njoftoi komandantin lidhur me punën e pjesëtarëve të kësaj kompanie në terren. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama i përgëzoi deminerët për punën e tyre të palodhshme dhe profesionale, si dhe për suksesin që ata janë duke treguar në pastrimin e zonave të minuara. Ai njëherësh premtoi mbështetjen e tij të vazhdueshme për Kompaninë e Deminimit.

Sekretari i MFSK-s takim lamtumirës me këshilltarët e NALT-it



Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Shkëlzen Sylaj, priti sot (14.07.2017) në takime lamtumirëse këshilltarët e NALT-it (Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s, për MFSK/FSK), znj. Jessica Olcot, këshilltare amerikane dhe nënkolonelin Flamur Melani këshilltar nga ushtria e Shqipërisë. Sekretari Sylaj, me këtë rast falënderoi znj. Olcot dhe nënkolonelin Melani për angazhimin dhe kontributin e tyre që kanë dhënë në afrimin e këshillave profesionale për MFSK/FSK-në.



Ndërsa, znj. Olcot dhe nënkolonel Melani falënderuan sekretarin Sylaj për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që patën gjatë punës një vjeçare në kuadër të NALT-it për MFSK/FSK-në.

Gjenerali Gëzim Hazrolli takoi shefen e Shtabit të KFOR-it, gjeneral Patricia Anslow

Zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli priti sot (18.07.2017) në ambientet e kazermës ,,Adem Jashari ",shefen e Shtabit të KFOR-it, gjeneral brigade Patricia Anslow dhe përfaqësues të komunikimit të Kampit Bondstell. Gjeneral Hazroli dhe gjeneral Patricia Anslow, gjatë takimit biseduan për të arriturat dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që FSK-ja ka me KFOR-in gjatë kësaj periudhe, duke u fokusuar në bashkëpunimin e ndërsjellët dhe mbështetjen në shumë fusha, si realizimi i ushtrimit të përbashkët ,,Silver Sabre" nga KFOR-i, FSK-ja, Policia e Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, pastaj mbështetja e shumë projekteve të përbashkëta humanitare për komunitetin, realizimi i trajnimeve të ndryshme, mbajtja e garave dhe aktiviteteve sportive, etj. Gjenerali Gëzim Hazrolli, me këtë rast e falënderoi gjeneralin Ansloë për mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së, gjatë udhëheqjes së saj dhe njëherësh i uroi suksese në të ardhmen, pasi që misioni i saj në Kosovë, do të përfundojë këtë muaj. Gjithashtu po sot, zëvendës komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli priti përfaqësuesit e sektorit të komunikimit të Kampit Bonstill, me të cilët ndau një kohë për t`i falënderuar për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe për ndihmën që kanë dhënë në ngritjen e kapaciteteve të komunikimit. Ai shtoi se: "Bashkëpunimi



me pjesëtarë të kampit Bonstill, ka qenë i vazhdueshëm, por në këtë fushë fokusi i është dhënë nga nëntori i vitit 2016, ku është realizuar ushtrimi fushor ,,SIlver Sabre" dhe pas këtij ushtrimi ka lindur nevoja, të cilat kishin të bënin me ndërveprushmërin e pajisjeve të cilat ka FSK-ja dhe mundësia e komunikimit me partnerët në operacione të përbashkëta me njësitë mike".Gjeneral Hazrolli, me këtë rast, falënderoi majorin Walter Work, për bashkëpunimin dhe për ndihmën që ka dhënë për ngritjen e këtyre kapaciteteve më se të nevojshme për komunikim të FSK-së. Ndërsa majori Walter Work, shprehu kënaqësinë e tij për mundësinë që i është dhënë për të punuar me pjesëtarë të FSK-së dhe stafin e kompanisë së komunikimit dhe u shpreh i entuziazmuar me të arriturat pasi që javën e kaluar veç kanë testuar ndërveprueshmërin dhe komunikimin nga Prishtina me Kampin Bonstill, dhe me një nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetin e Ilinois-it, dhe ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen, tha majori Work.

Nëntogeri Genti Koçinaj studenti ndërkombëtar më i mirë i klasës, në SHBA



Nëntogeri i Forcës së Sigurisë të Kosovë (FSK), Genti Koqinaj, diplomoi në "Kursin Bazik të Oficerëve për Komunikim" në SHBA, ku si shpërblim për rezultatet e treguara gjatë këtij trajnimi, nga shefi i Shtabit të "Cyber Center of Excellence" në bazën Fort Gordon mori çmimin "Col. Alan C. Dexter", çmim ky i cili i jepet studentit ndërkombëtarë më të mirë të klasës, që tregon performancë të jashtëzakonshme akademike dhe udhëheqëse. Nëntogeri Koçinaj, Kompania e Komunikimit të FSK-së, kursin bazik të oficerëve për komunikim e ka filluar nga data 22 Shkurt 2017 dhe e ka përfunduar më 21 Qershor 2017, në Shkollën e Sinjaleve të Ushtrisë Amerikane, në Fort Gordon, Georgia, ku pjesëmarrës kanë qenë 53 kadetë nga shtete të ndryshme të botës, si nga Amerika, Kosova, Hungaria, Arabia Saudite dhe Bosnja e Hercegovina. Ky kurs SBOLC, ka qenë i ndarë kryesisht në dy pjesë: pjesa e njohurive të përgjithshme për oficer dhe pjesa e njohurive specialistike për fushën e komunikimit. Pjesa e parë e kursit ka përmbajtur tema si: procedurat e udhëheqjes së trupave, menagjimi i trajnimit të njësisë, taktikat me njësi të vogla, operacionet paqeruajtëse, operacionet e mirëmbajtjes, operacionet me konvoj, navigim tokësor, kualifikim në gjuajtje me armë etj.Ndërsa pjesa e dytë ka përfshirë temat, si: WIN-T (Warfighter Information Network - Tactical), IT essentials, Hyrje në Rrjeta, Siguria kibernetike, shpërndarja e energjisë elektrike, PVMU dhe roli i S6, CPOF, TOCNET dhe zhvillimi i karrierës së oficerëve të komunikimit. Dy javët e fundit të trajnimit kanë kulminuar me Planifikim të Ushtrimit Fushor dhe realizim të Ushtrimit Fushor 5 ditor. Gjatë zhvillimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit kanë marrë pjesë rregullisht në ushtrime fizike si dhe janë sprovuar me role dhe pozita të ndryshme, duke përfshirë këtu; S1, S2, S3, S4, S6, komandant togu, udhëheqës skuadre apo udhëheqës ekipi. Pas rezultatit të treguar nëntoger Koqinaj është caktuar dy herë në pozitën e komandantit të togut, pozitë kjo e cila zakonisht është e rezervuar vetëm për oficerë amerikan dhe jo ndërkombëtar. Nëntoger Koqinaj, gjatë kësaj periudhe ka arritur që krahas këtij kursi të ndjek edhe trajnimin shtesë për Mbrojtje të Afërt Luftarake, ku është certifikuar për nivelin e parë të këtij programi.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

FSK-ja në stërvitjen shumëkombëshe "KFOR 23" në Gjermani

Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), i komanduar nga kapiten Fatmir Lani dhe i përbërë prej 16 pjesëtarëve, një skuadër(9 pjesëtarë) e Kompanisë për Mbrojtje Kimike- Biologjike-Atomike(MKBA) dhe një ekipi (5 pjesëtarë) për Eliminimin e Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyera (EOD) e Kompanisë së Deminimit, si dhe dy vëzhgues-kontrollues, nga data 19 qershor deri më 11 korrik 2017, po merr pjesë në ushtrimin e përbashkët ,,KFOR 23" në Bazën e Ushtrisë Amerikane për Evropë (USAREUR), në Qendrën e Bashkuar Shumëkombëshe për Gatishmëri (JMRC), në Hohenfild të Republikës Federale të Gjermanisë. Për të parë nga afër operacionet përfundimtare të ushtrimit ,,KFOR 23" të kontingjentit të FSK-së, i cili i është bashkuar Brigadës 39-të të Këmbësorisë (39th IBCT) të Ushtrisë Amerikane për Evropë (USAREUR), në Ditën e Vizitorëve në Gjermani, përveç personaliteteve të shumta ushtarake amerikane, gjermane dhe të vendeve tjera të NATO-s, qëndruan dje, edhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës si dhe zotëri Jahir Sejdiu. Gjenerali Halimi, nga drejtuesit e ushtrimit, mori komente dhe vlerësime shumë të larta për angazhimin, disiplinën dhe profesionalizmin që po tregojnë pjesëtarët e FSK-së. Gjatë aktiviteteve trajnuese dhe stërvitore të ushtrimit, Ekipi i EOD-së ka për mision që të detektojë dhe shkatërrojë mjetet e pashpërthyera, ndërsa skuadra e MKAB-së të bie në kontakt me autoritetet lokale për të bërë vlerësimin e zonës së kontaminuar. Kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, pas përfundimit me sukses të ushtrimit ,, KFOR 24", i cili u drejtua nga Qendra e Bashkuar Shumëkombëshe për Gatishmëri, pritet që të kthehet në vend për të vazhduar shërbimin me profesionalizëm dhe përkushtim.



Koloneli Tahiraj dhe delegacioni mjekësor i FSK-së vizitë në Regjimentin Mjekësor të Mbretërisë së Bashkuar

Një delegacion i përbërë nga personeli mjekësor i FSK-së, i kryesuar nga drejtori i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), koloneli Xhevdet Tahiraj, gjatë këtij muaji qëndroi për vizitë zyrtare në Regjimentin Mjekësor të Mbretërisë së Bashkuar. Delegacioni i FSK-së, fillimisht u prit nga nënkolonel Paul Jackson, komandant i Regjimentit të 5-të Mjekësor në Catterick të North Yorkshire. Gjatë takimit të përbashkët ata biseduan kryesisht lidhur me personelin mjekësor, pajisjet mjekësore dhe gatishmërinë operacionale të të dyja forcave.Pjesëtarët e delegacionit të FSK-së patën mundësinë që të shohin nga afër edhe validimin e Rolit 1 në Regjimentin 5 Mjekësor të Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar.Gjithashtu oficerët e FSK-së zhvilluan një vizitë edhe në Regjimentin e 2-të Mjekësor, ku u pritën nga nënkolonel Worthington Ramc dhe personeli tjetër i Regjimentit të 2-të në North Luffenham Oakham të Mbretërisë së Bashkuar.Të dyja palët konfirmuan vazhdimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e mjekësisë edhe në të ardhmen.Vizita e delegacionit të MFSK-së dhe FSK-së në Mbretërinë e Bashkuar u realizua me angazhimin e këshilltarit britanik të Komandantit të FSK-së, nënkolonel Gregori Linday. Pjesë e këtij delegacioni përveç dr. Xhevdet Tahirajt ishin edhe oficerët: nënkolonel Arife Halili, major Genc Shala, toger Lirim Hamiti si dhe rreshter majori Ilir Rama.



Oficerë dhe familjarë të Forcave të Armatosura të Turqisë vizituan FSK-në

Një delegacion (10 anëtarësh) nga stafi ushtarak i FA turke, prej datës 22-28.06.2017, qëndruan si mysafirë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Vizita kishte karakter social dhe kulturor dhe u realizua në kuadër të bashkëpunimit midis MFSK-së dhe Ministrisë së FA të Turqisë mbi shkëmbimin e personelit ushtarak dhe civil.Delegacioni nga Turqia është pritur edhe nga drejtori i Departamentit të Operativës të MFSK-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, si dhe nga disa oficerë të lartët të FSK-së, të cilët e shoqëruan delegacionin gjatë tërë kohës së qëndrimit të tij në Kosovë.Mysafirët nga Forcat e Armatosura të Turqisë kanë realizuar edhe vizita të shumta nëpër vende të ndryshme historike dhe me interes kulturor si në Kosovë, Maqedoni dhe në Shqipëri. Vizita është realizuar sipas agjendës së paracaktuar dhe mysafirët u shprehen mjaft të kënaqur dhe falënderues për pritjen



Rreshter Majori Metaj ligjëroi në akademinë ushtarake kroate

Në Akademinë Ushtarake të Mbrojtjes "Dr. Franjo Tugjman" në Zagreb të Republikës së Kroacisë, nga data 03.07.2017, u mbajt kursi profesional dyjavor i Kursit të liderëve të komandave"(Command Sinior Enlisted Leaders Course). Gjatë punimeve të kursit, para të pranishmëve Genc Metaj, rreshter majori i parë i Forcës së Sigurisë të Kosovës, u paraqit me temën procesi i marrjes së vendimeve në ushtri si dhe roli i nënoficerëve të lartë në vendime madhore, e cila u pëlqye nga të pranishmit për profesionalizimin dhe thellësinë tematike. Në këtë aktivitet morën pjesë; nënoficerët me gradën-rreshter major madhor, nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina.



FSK-ja vazhdon realizimin e projekteve humanitare për komunitetet

Me kërkesën e komunitetit të fshatit Pasian dhe të udhëheqjes së KK Parteshit dhe pas vlerësimit nga Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak (DBCU) dhe me mbështetjen e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës është realizuar projekti humanitar në zgjerimin dhe trasimin e rrugës të fshatit Pasian, komuna e Parteshit, me gjatësi mbi 1 mijë metra dhe gjerësi 5 metra. Ky projekt është realizuar nga Batalioni i xhenios i Brigadës së Mbështetjes Operacionle të FSK-së, nga data 03-12.07.2017, në ndihmë komunitetit serb të këtij fshati. Kjo rrugë do t'u mundësojë qarkullimin më të lirshëm të banorëve për nevojat e tyre, pasi komuna e Parteshit si komunë e re, nuk ka mjete për realizimin e shumë projekteve dhe është cilësuar e nevojshme që t`u dalë në ndihmë këtyre banorëve. Ky projekt si dhe projektet e tjera të realizuara nga FSK-ja, janë falë bashkëpunimit të mirë që ka Forca e Sigurisë së Kosovës me të gjitha komunat në nivel të Republikës së Kosovës.

Certifikohën rekrutët e FSK-së nga radhët e komuniteteve jo-shumicë

Sot (07.07.2017) në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e diplomimit të 61 rekrutëve të FSK-së, nga radhët e komunitetit jo- shumicë, pas kryerjes së kursit bazik, "Gjenerata e parë 2017". Në ceremoninë e diplomimit të rekrutëve mori pjesë edhe Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK) z. Haki Demolli, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK-së) gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, z. Greg Delawie, oficerë, nënoficerë dhe familjarë të rekrutëve dhe të ftuar të tjerë. Në ceremoninë e diplomimit të pjesëtarëve të FSK-së nga komuniteti jo-shumicë, me një fjalë përmbajtjesore u paraqit presidenti i Kosovës, z. Hashim Thaçi, njëherësh edhe Komandant Suprem i FSK-së, i cili përgëzoi rekrutët e rinj të FSK-së nga radhët e komuniteteve jo- shumicë për zgjedhjen që ata kanë bërë për t'i shërbyer vendit si ushtarë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, Presidenti i Republikës, z. Thaçi foli për të ardhmen e FSK-së, pikërisht për transformimin e saj, ku ndër të tjera tha: ,,Në përputhje me rekomandimet e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë dhe në koordinim të plotë me partnerët tanë strategjikë po punojmë për ta përfunduar transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës". Në fund, zotëri Hashim Thaçi tha se transformimi i FSK-së është një



proces që ka kaluar në faza të ndryshme, por gjithmonë drejt arritjes së qëllimit të



qartë dhe në dobi të qytetarëve tanë pa asnjë dallim, duke theksuar gjithashtu se janë arritur edhe hapat final dhe se këta hapa do t'i hedhim së bashku dhe në koordinim të plotë me aleatët tanë ndërkombëtarë, - u shpreh z. Thaçi. Ndërsa, ministri në largim i MFSK-së, z. Haki Demolli, me rastin e diplomimit të rekrutëve, veç tjerash tha: "Sot, në këtë ceremoni rasti, kam nderin, që t'ju uroj certifikimin me sukses "Gjeneratës së rekrutëve të FSK-së të vitit 2017", të stërvitur dhe të trajnuar nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS-së). Certifikimi i 61 rekrutëve, pas përfundimit të trajnimit intensiv 9-javor, është një hap i radhës i rëndësishëm në ngritjen dhe plotësimin e kapaciteteve njerëzore të FSK-së, që krijon bazën e mirë për ecjen tonë drejt realizimit të objektivave tona ligjore, e që janë krijimi i një forcë operacionale, fleksibile dhe profesionale e cila do të jetë e aftë t'i realizojë me përkushtim dhe përpikëri të gjitha detyrat e saj. Po theksoj se certifikimi i sotëm e ka të veçantën e vet, sepse përmes tij, jo vetëm që po bëhet plotësimi i kapaciteteve njerëzore të strukturës së FSK-së, por po bëhet edhe përmbushja e numrit të pjesëtarëve të FSK-së nga radhët e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, duke pasqyruar në mënyrë të kënaqshme diversitetin etnik të qytetarëve të shtetit tonë. Rekrutët e certifikuar sot janë kryesisht nga komuniteti serb dhe malazez, fakt ky, që na gëzon shumë, sepse dëshmon se FSK-ja është bërë forcë e dashur dhe e besueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, forcë shumetnike, e hapur për të gjithë dhe në shërbim të të gjithëve". Ministri Demolli falënderoi edhe familjarët e rekrutëve, të cilët inkurajuan fëmijët e tyre që të bëhen pjesëtarë të FSK-së, duke bërë kështu veprimin e duhur. Në fund u zhvillua ceremonia e ndarjes së certifikatave, ku rekrutët bënë Betimin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Diplomuan kadetët e FSK-së, gjenerata 2017

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së, në Ferizaj, (12.07.2017)sot u mbajt ceremonia solemne e diplomimit të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, gjenerata 2017. Në ceremoninë e diplomimit prezent ishin: ministri për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës, z. Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministri i FSK-së, Muhamet Latifi, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e





Kosovës, z. Ramush Haradinaj, komandanti i KFOR-it, gjeneral-major Giovanni Fungo, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Dietmar Mosman, zëvendës drejtori i NALT-it Mark Theobalt, ambasadorë, atashetë e akreditуar në Kosovë, përfaqësues nga Policia e Kosovës dhe Pushtetit Lokal, stafi i lartë i MFSK/FSK, familjarë të kadetëve si dhe oficerë, nënoficerë dhe ushtar të FSK-së. Ceremonia e diplomimit dhe gradimit të kadetëve të QSU-së, filloi me intonimin e himnit të Republikës së Kosovës. Në fjalën e tij, ministri i Ministrisë së FSK-së, z. Haki Demolli, diplomimin dhe gradimin e kadetëve të FSK-së, e cilësoi si një ditë të veçantë për të dhe FSK-në. "Për mua si ministër i FSK-së, dita e sotme e diplomimit dhe gradimit tuaj në gradën e nëntogerit, është një ditë e shumë pritur, është një ditë e kurorëzimit të një pune tuaj të gjatë, është dita e realizimit të ëndrrave tuaja, e cila juve ju ka shtyrë para 4 viteve që të vendosni për t'u bërë pjesë-



tarë të FSK-së, pra që të bëheni oficerë të karrierës. Realizimi i ëndrrës tuaj rinore, siguristë se ka kërkuar punë këmbëngulëse, angazhim dhe disiplinë maksimale në njërën dhe sakrificë në anën tjetër.

Kjo është dita e cila shënon kalimin në një fazë të re zhvillimi, sepse juve ju hapet mundësia për t'u aktivizuar në FSK si oficerë aktiv. Diplomimi dhe gradimi i kadetëve është një shembull i mirë i zhvillimit dhe i ngritjes profesionale të FSK-së, përmes investimit në dije dhe në shkencë.Kjo është dëshmia më e mirë, se ne po e krijojmë një forcë profesionale, konform standardeve më të larta ushtarake, pra sipas kritereve dhe standardeve të NATO-s. Më duhet të theksoi, se diplomimi i juaj është më ndryshe se sa diplomimi i gjeneratave të tjera, sepse ju po diplomoni në vitin



kur ne si Ministri e FSK-së, kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, për të filluar dhe zhvilluar procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK). Themelimi i Forcave të Armatosura të Kosovës, do të krijojë mundësi të mëdha, jo vetëm që ju të ofroni shërbime më të mira popullit dhe shtetit tonë, por edhe mundësi për avancimin dhe ngritjen tuaj profesionale ushtarake.

Në fund, ministri Demolli i përgëzoi kadetët, stafin akademik trajnues të KDS-së, dhe të QSU-së, për punën e tyre të palodhshme në përgatitjen dhe stërvitjen e kësaj gjenerate si dhe falënderoi familjarët e kadetëve për përkrahjen maksimale në rrugëtimin e tyre gjatë studimeve në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së. Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij, pasi përshëndeti të pranishmit, tha se ndihet shumë mirë, në ditën e diplomimit të kadetëve: "E di që rrugëtimi i juaj deri këtu nuk ishte i lehtë. Ju kaluat sfida të mëdha fizike dhe mentale, me të vetmin qëllim që të edukoheni dhe të përgatiteni për t'i shërbyer vendit dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Por më duhet të ju them që ky është vetëm fillimi i rrugëtimit tuaj në këtë profesion fisnik. Gjatë karrierës tuaj, ju do të ballafaqoheni me sfida të ndryshme, të cilat ju si udhëheqës, duhet t'i jepni drejtim dhe zgjidhje. Nga ju pres që të jeni udhëheqës të ndershëm, të guximshëm dhe të punoni me përkushtim. Gjithashtu, pres nga ju, që të gjitha vështirësitë me të cilat do të ballafaqoheni në të ardhmen, t'i ktheni në mundësi, se vetëm kështu ne do të zhvillojmë dhe avancojmë institucionin tonë që të jetë i gatshëm të përmbush misionin e vet, t'u dalë në ndih-



përgjegjësitë dhe detyrat tuaja shumëfishohen. Ju kaluat nëpër këtë qendër për katër vite nëpër një sistem të avancuar shkollimi dhe trajnime të vështira, ku u brumoset me vlerat dhe virtytet më të larta si nderi, detyra, atdhe-dashuria, integriteti, humanizmi dhe vetëmohimi". Pas leximit të urdhrit për gradimin e kadetëve në gradën e nëntogerit, ministri Demolli, gjeneral Rama, komandanti i KFOR-it, gjenerali Fungo, gjenerali Cikaqi dhe majori Kiqina u dhanë certifikatat, oficerëve të rijnë të FSK-së. Para komandantit të QSU-së, majorit Avni Kiqina, kadetët e sapo diplomuar dhanë betimin solemn. Më pas, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama i dorëzoi kadetit, Vilson Musajt, çmimin "Kadeti më i mirë i gjeneratës 2017".

Reportazh i botuar në gazetën e Gardës Kombëtare të Ajovës-SHBA

Ushtria e Ajovës dhe personeli mjekësor i Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare ushtrojnë së bashku me ekipin e mjekëve të Kosovës

Ushtria e Ajovës dhe personeli mjekësor i Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare ushtrojnë së bashku me ekipin e mjekëve të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar

Shkruar nga kapiteni Brandon Cochran dhe kapteri Michael J. Kelly, publikuar më 27 korrik 2017

Në ndërtim të partneritetit gjashtëvjeçar, ushtarët dhe pjesëtarët e Forcës Ajrore nga Garda Kombëtare e Ajovës së bashku me pjesëtarët e Kompanisë Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK) morën pjesë në kursin dhe ushtrimin fushor mjekësor shumëdimensional dyjavor në Qendrën Trajnuese Mbështetëse(QTM) në kampin Dodge Joint Maneuver Training Center (CDJMTC) si pjesë e Programit për Partnership Shtetëror (PPSh). PPSh lidh SHBA-të me vendet partnere në tërë botën për të promovuar qasjen, rrit kapacitetet, përmirëson ndërveprueshmërinë dhe rritë parimet e përgjegjësisë qeverisëse. Ky është një program tradicional i ndihmës në siguri, që ka për qëllim shkëmbimet mes ushtrive. Këto aktivitetet zakonisht janë të vogla dhe përfshijnë nga 4 deri 6 ushtarë, pjesëtarë të Forcës Ajrore ose pjesëtarë të FSK-së që punuan së bashku për 5 deri 7 ditë. Pjesëmarrës ishin edhe një pjesë e personelit mjekësor nga Mbretëria e Bashkuar."Programi ynë i Partneritetit Shtetëror me Kosovën vazhdon të bëjë përparim të madh që nga krijimi i tij në mars të vitit 2011 dhe ka evoluar si një nga programet më të mira të Gardës Kombëtare" tha Gjen Maj Timothy Orr, gjenerali i Ajovës në raportimin e tij" gjendja e Gardës" tek Asambleja e Ajovës në janar të vitit 2011. Në ndërtim të shumë aktiviteteve të PPSh-s në vend, nga vera dhe vjeshta e 2016, planifikuesit e mjekësisë nga Ajova dhe Kosova kanë punuar së bashku për të identifikuar objektivat që rrisin aftësitë dhe përvojën drejtuese të personelit mjekësor dhe kanë hulumtuar mundësitë e kombinuara të angazhimit të "detyrave luftarake".

Për vazhdimin e momentit të fituar vjeshtën e kaluar gjatë ushtrimit fushor Shqiponja V në Prizren, Kosovë, personeli mjekësor nga FSK së bashku me pesë pjesëtarë të MEDHAWKS nga grupi mjekësor i Batalionit 132, ju bashkuan Batalionit mjekësor shumëdimensional të përberë nga ushtarët e Kompanisë Mjekësore 134(ambulancë tokësore), Kompania Mjekësore 209 dhe 294 (mbështetja në terren) për periudhën e tyre të trajnimit kolektive në QTM.

"Ka qenë ëndërr për mua të ushtrojmë krahë përkrah me ushtarët dhe pjesëtarët e Forcave Ajrore tha major, dr. Genc Shala, zëvendëskomandanti i Kompanisë së Mjekësisë. "Duke punuar së bashku si një ekip në mbështetje të misioneve mjekësore, ne ndërtojmë edhe bashkëpunimin mes nesh. Në fund të trajnimit, u duk sikur të kishim punuar së bashku me vite. Gjatë kësaj periudhë dyjavore në QTM, ata patën mundësinë të trajnohen në Qendrën mjekësore simulantëve trajnuesku ata fituan dhe demonstruan aftësi jetike të shpëtimit të jetës në luftë, të kryejnë dhe perfeksionojnë detyrat individuale mjekësore në ambiente të trajtimit mjekësor si dhe të marrin pjesë dhe të ritën si lider gjatë trajnimit dhe seminarit të personelit të sektorëve në procesin e vendimmarrjes ushtarake. "Fiziologjia njerëzore është e njëjtë pa marr parasysh se çfarë kombi je apo në çfarë dege je duke shërbyer tha tekniku rreshteri Davy Crockett NCO, kryesor për kujdes I 132 MDG. Kur është puna tek kujdesi mjekësor, gjuha është e njëjtë, gjaku është i kuq kudo". Elementi kryesor i periudhës së trajnimit kolektiv të njësisë është pjesa e programit të ushtrimit fushor. E zhvilluar zakonisht në javën e dytë të trajnimit, pjesëtarët e MMB109, MDG132 dhe Kompania e Mjekësisë u bashkuan si një ekip gjatë përsëritjeve të shumta të UF për t'u zhvilluar dhe trajnuar për rolin IIMTF, komplet me pajisjet e tyre, furnizimet dhe pacientet.Skenari i trajnimit përmbledh të gjitha aspektet e kujdesit mjekësor nga pika e lëndimit tek Roli i kujdesit taktik për lëndimet në luftë e deri tek Roli II i evakuimit dhe stabilizimit dhe përfundimisht evakuimi mjekësor për tek një njësi tjetër mjekësore. "Trajnimi i përbashkët kolektiv ndërkombëtar shfrytëzon njohuri nga të gjithë individët e përfshirë dhe e fut atë në një element kolektive, duke krijuar kështu kualitetet tjetër" tha Maj. Jamie Clasen, komandant i 209th MCAS. Kjo pjesë e trajnimit bëhet për të parë nëse njësia ka aftësi të kryejë listën esenciale të detyrave të misionit të komandantit dhe detyrat kryesore kolektive të njësisë.

Përderisa qëllimi kryesor i këtij trajnimi prek angazhimin e personelit dhe pajisjeve, menaxhimin e dëmeve në kushte të vështira, dhe kryerja e operacioneve të ROLIT II mjekësor, objektivi kryesor gjatë dy javëve të fundit ka qenë trajnimi i Rolit I dhe II dhe integrimi i ushtarëve, të pjesëtarëve të Forcës Ajrore dhe personelit të FSK-së në një njësi të vetme për ushtrime me fokus të veçantë në trajnim kolektiv.







Intervistë me Dr. Genc Shala- zv.komandant i Kompanisë së Mjekësisë, pas trajnimit në SHBA

Trajnime profesionale të improvizuara në ambiente dhe strese të luftës

Me ftesë të Gardës Kombëtare të Ajovës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), nga data 15-28 korrik 2017, pesë pjesëtarë (mjekë-infermierë) të FSK-së, morën pjesë në trajnimin-ushtrimin fushor "Zhvillimi i liderëve të rijnë" mbajtur në Camp Dodge, në shtetin e Ajovës.Ekipi i mjekëve të FSK-së, në ushtrimin fushor u fuzionua me ekipin e gardës Kombëtare të Ajovës dhe Forcave Ajore të Gardës Kombëtare të Ajovës. Gjatë trajnimit, ata u pajisen me njohuri për intervenime mjekësore, duke simuluar gjendje lufte. Pas kthimit nga SHBA-të, biseduam me majorin Dr. Genc Shala- zëvendëskomandant i Kompanisë së Mjekësisë dhe njëherësh udhëheqës i ekipit të FSK-së në trajnimin fushor në SHBA.

Gazeta Forca Jonë: Major Shala, ditë më parë, ju u kthyet nga SHBA-të, pas pjesëmarrjes në një ushtrim fushor dyjavorë të organizuar nga Garda Kombëtare e Ajovës?

Major Dr. Genc Shala: "Po, për dy javë kemi marrë pjesë në trajnimin e ashtuquajtur "Zhvillimi i liderëve të rijnë" i cili u mbajt në organizim të Gardës Kombëtare të Ajovës, dhe është zhvilluar në terren të hapur, model i ushtrimeve fushore që zhvillohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në të cilin ushtrim kanë marrë pjesë edhe Kompanitë e Mjekësisë të Ushtrisë së Gardës Kombëtare të Ajovës, pjesëtarë të Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare të Ajovës, 5 pjesëtarë të FSK-së dhe dy pjesëtarë të Mbretërisë së Bashkuar.

Gazeta Forca Jonë: Ekipi i FSK-së, për herë të parë merr pjesë në një trajnim të nivelit të lartë profesional, këtu në SHBA, cilat ishin përvojat në këtë drejtim?

Major Dr. Genc Shala: Është hera e parë që kemi marrë pjesë si ekip në një ushtrim fushor të këtij niveli. Gjatë këtij ushtrimi kemi vepruar në ekipe të përziera, me qëllim jo vetëm të ngritjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit, por edhe të këmbimit të përvojave mes njëri -tjetrit në të ardhmen. Puna e përbashkët në një ekip të përzier të FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës, ishte vetëm një ëndërr për mua, por tanimë e realizuar, duke shpresuar se në të ardhmen do të dislokohemi së bashku në misione të vërteta.Gjatë punës në ekip me pjesëtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës jam ndier thuajse punoj me ta që 10 vite. Atje kemi mësuar për organizimin e shërbimeve mjekësore të Rol 1, Rol 2 (shërbime mjekësore sipas standardeve të NATO-s) dhe evakuimin mjekësor në terren. Kemi mësuar edhe përdorimin e pajisjeve të reja mjekësore. Gjithashtu jemi njoftuar edhe me PSO-të e Kompanive Mjekësore të Gardës Kombëtare të Ajovës.

Gazeta Forca Jonë: A mund të tregoni si organizohen ushtrimet praktike fushore të mjekëve nga Garda Kombëtare e Ajovës?

Major Dr. Genc Shala: Këto ushtrime janë të një niveli shumë të lartë, që rrallë mund t'i hasësh në shtete tjera. Qendra e Trajnimeve dhe Simulimeve Mjekësore, këtu, ka ofruar trajnim me simulime; si në ambiente të luftës, ku personeli mjekësor iu nënshtrua testimit të dhënies së ndihmës mjekësore nën streset e luftimit.





Gazeta Forca Jonë: Sa keni përfituar nga ky trajnim?

Major Dr. Genc Shala: Ne për herë të parë kemi marrë pjesë në trajnime të tilla, dhe siç e theksova edhe më lartë, ajo që neve na ka ndihmuar shumë në aspektin profesional ka qenë puna në ekip të përzier. Dhe besojë se ky ushtrim dhe ushtrimet tjera në të ardhmen do të na ndihmojnë që të ngremë lartë nivelin e mjekësisë në FSK, falë Ushtrisë amerikane dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, me të cilët kemi një bashkëpunim të shkëlqyer. Tashmë e kemi më të qartë organizimin e shërbimeve mjekësore në terren sipas Role 1 dhe Role 2.

Gazeta Forca Jonë: Gjatë vizitës jeni pritur edhe nga stafi i lartë i Gardës Kombëtare të Ajovës?!

Major Dr. Genc Shala: Edhe një herë dëshiroj ta falënderoj komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës-gjeneral majorin Orr dhe Gardën Kombëtare për mikpritjen e shkëlqyeshme si dhe për bashkëpunimin dhe shoqërimin e pjesëtarëve të FSK-së. Gjatë pjesëmarrjes sonë në ushtrimin fushor, jemi ftuar edhe në familjet e oficerëve dhe nënoficerëve të GKA-së, dhe në veçanti nga Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral major Timothy Orr, në ambientin e tij familjar, që ka qenë një nder i madh i treguar jo vetëm për pjesëmarrësit e FSK-së në Ajova, por me këtë, gjenerali Orr ka treguar që ka respekt të madh për FSK-në dhe për popullin e Kosovës në përgjithësi, pra është një mik i madh i Kosovës.Gjithashtu gjatë ushtrimit fushor në SHBA, u pritëm në vizitë në Konsullatën e Kosovës në Ajova nga konsulli z. Xhavit Gashi. Me ne në pritje ishin edhe ushtarët e GKA-së dhe dy medikët e Mbretërisë së Bashkuar. Konsulli ka ndarë kohë të çmuar që të na pres edhe në familjen e tij, me ç 'rast shfrytëzoj rastin ta falënderoj në emrin tim personal dhe të ekipit që ishim në Ajova. Gjatë ushtrimit fushor na vizitoi edhe atasheu ushtarak i FSK-së në Uashington, kolonel Ilir Qeriqi, që ishte një frymëzim shtesë për ne.Gjithashtu kemi vizituar edhe Capitol Hill, ku përveç një ambienti madhështor vërejtëm se në shumë nga zyrat e përfaqësuesve shtetërorë kishte simbole të Republikës së Kosovës, që na bën të ndihemi shumë krenarë. Kjo për mua tregon përkushtimin e Shtetit të Ajovës në partneritetin shtetëror që kemi.Lidhur më këtë pyetje, përgjigja ime përfundimtare do të ishte: Çdo çast jam ndier sikur gjendem në shtëpinë time, në Kosovë.


Gazeta Forca Jonë: Z. doktor, si do t'i përcillni këto zhvillime në njësitet e FSK-së?

Major dr. Genc Shala: Në kuadër të ushtrimit fushor të Ajovës; kanë qenë përfaqësuesit e shumicës së njësive mjekësore të FSK-së, si p.sh; major dr. Enver Beqiri nga Batalioni i 2-të i BRSH-së, kapiteni dr Gëzim Kunoviku-mjek rezervë, kapter Rifadije Ramadani- Kompania e Mjekësisë dhe rreshter Shukrije Basholli nga Batalioni i 2-të. Ne kemi një plan që këto përvoja do t'i fillojmë t'i zbatojmë në të gjitha njësitet e FSK-së, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë praktik.



FSK-ja realizoi me sukses ushtrimin 'Beretat në Veprim'

Pjesëtarët e Kompanisë 1A, të Batalionit të Parë të Reagimit të Shpejtë të FSK-së, (3.7.2017) kanë zhvilluar ushtrimin fushor treditor "Beretat në Veprim", i cili u realizua në zonën e përgjegjësisë të fshatit Marevc. Kompania 1A, me të zbarkuar në fshatin Marevc ka ngritur kampin fushor duke menaxhuar situatat përmes Qendrës operative taktike në detyrat: mbrojtja e marshit rrugor, vijë-rrethim, kordon- kërkim, vëzhgim terreni, perimetër të sigurisë, pikë- kontrolli, patrullim etj. Për t'i përcjellë aktivitetet ishin të pranishëm edhe komandanti i Batalionit të Parë nënkolonel Haki Xhemajli dhe rreshter majori i Batalionit të Parë Gani Dilaveri. Gjatë këtij ushtrimi, i cili u realizua sipas planit vjetor të trajnimeve dhe aktiviteteve të Batalionit të Parë, Kompania 1A testoi aftësitë e saj për të operuar ditën dhe natën qëndrueshmërinë operacionale, nivelin e shkathtësive taktike dhe operimin me mjete të blinduara. Aktivitetet të cilat janë realizuar dhe ato që po realizohen nga kompanitë, kanë ngritur nivelin e përgatitjes profesionale te pjesëtarët e Batalionit të Parë në të gjitha fushat. Ky ushtrimi vërtet ishte sfidues, aq më tepër që gjatë zhvillimit të tij mbretëruan temperatura shumë të larta, pjesëtarët e Batalionit të Parë, falë përgatitjes së lartë fizike dhe taktike, treguan gatishmëri, vullnet dhe dëshirë të jashtëzakonshme për t'u përballur me detyrat që iu caktuan gjatë këtij misioni.



Përfundoi Faza e Trajnimeve Kolektive për ushtrimin fushor "Shqiponja Patrulluese 17"

Nga data 19 qershor 2017, pjesëtarë të përzgjedhur nga të gjitha njësitë e FSK-së i janë nënshtruar trajnimeve të ndryshme përgatitore të zhvilluara nga ekipet Britanike dhe në bashkëpunim me ekipet e FSK-së, të cilat përfunduan më 14 korrik 2017. Gjatë katër javëve, pjesëtarët e FSK-së, kanë kryer tri trajnime të ndryshme: Kursi i Udhëheqjes për Komandues të Rijnë, Kursi për Taktika, si dhe Kursi i Ndihmës së Parë të Avancuar. Qëllimi i mbajtjes së këtyre trajnimeve kolektive ishte përgatitja e pjesëtarëve në nivelin taktik dhe fizik për të qenë të gatshëm të marrin pjesë në ushtrimin i cili do të mbahet në fillim të muajit tetor të këtij viti. Më datë 13 korrik 2017, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve; përgjegjës të skuadrave garuese, për ushtrimin



fushor "Shqiponja Patrulluese 2017". Realizimi i këtij trajnimi u mundësua nga ekipi ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar i sistemuar në Republikën Çeke (BMATT) në kontakt të vazhdueshëm me oficerë të FSK-së dhe grupin planifikues të SHP17. Në ceremoninë e certifikimit ishin prezentë: gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe të Mbretërisë së Bashkuar. Me këtë rast, para të pranishmëve, gjenerali Enver Cikaqi theksoi rëndësinë e veçantë të këtij trajnimi në përgatitjen e pjesëtarëve të FSK-së, për garën "Shqiponja Patrulluese 17" duke vlerësuar lartë përkushtimin e ekipit Britanik, në bartjen e njohurive dhe eksperiencave të tyre tek pjesëtarët tanë. Ndërsa, më datë 14 korrik 2017, në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt ceremonia e certifikimit për kryerjen e trajnimeve "Kursin për Taktika dhe "Kursin për Ndihmë të Parë të Avancuar". Realizimi i këtyre kurseve u mundësua nga ekipet ekzekutuese të trajnimit i kombinuar nga oficerë të BRSH-së dhe nënoficerë të Ushtrisë së Britanisë së Madhe (Batalioni 1st Royal Irish) si dhe ekipi mjekësor i Forcës së Sigurisë të Kosovës. Në ceremoninë e certifikimit të këtij trajnimi të pranishëm ishin edhe zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i Shtabit të KFT-së kolonel Naim Haziri dhe shefi i Operatives në KFT kolonel Bashkim Shillova. Me këtë rast para të pranishmëve foli gjenerali Gëzim Hazrolli i cili falënderoi instruktorët për kohën që kanë ndarë për t'i shpërndarë eksperiencat e tyre tek pjesëtarët e FSK-së, dhe njëherë përgëzoi pjesëtarët për angazhimin maksimal të treguar gjatë këtij kursi. Mes të tjerave ai tha "asnjëherë nuk mjaftojnë trajnimet, aktivitetet dhe përgatitjet e ndryshme që arrijmë nga kurse dhe trajnime të tilla, ne tanimë kemi ngritur standardet tona, dhe këto standarde nuk guxojmë t'i zbresim por duhet të vazhdojmë edhe më tutje të punojmë që t'i mbajmë këto standarde të cilat i kemi arritur me punë dhe përkushtim të madh." Në shenjë mirënjohje dhe vlerësimi të punës së tyre, me certifikata vlerësimi nga gjeneralët Hazrolli dhe Cikaqi u shpërblyen të gjithë pjesëtarët e Ekipit nga Mbretëria e Bashkuar (BMATT).

"Bexhin e Zotësisë "e fitojnë 18 pjesëtarë të FSK-së

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) të FSK-së, në Prishtinë, më 19.07.2017, u mbajt ceremonia e dhënies së bexhave për pjesëtarët e FSK-së, të cilët përfunduan garën për "Bexhi i Zotësisë".Realizimi i kësaj gare, të mbajtur gjatë muajit qershor-korrik, u mundësua nga Forcat e Armatosura të Gjermanisë Federale në bashkëpunim me këshilltarët e NALT-it (Ekipi Këshillues Ndërlidhës të NATO-s, për FSK-në). Me këtë rast, zëvendës komandanti i KFT-së, gjenerali Gëzim Hazrolli pasi falënderoi gjeneralin Dietmar Mosmann për organizimin e kësaj gare, shtoi se: "Bexhi i zotësisë organizohet në shumë vende të botës, dhe në të ardhmen ju keni mundësinë që të njoftoheni me kolegët tanë kudo në misione të ndryshme, përmes këtij Bexhi. Prandaj, ne jemi duke punuar të arrijmë standardet tona, dhe jemi duke shikuar, që në të ardhmen nga standardet e bexhit të zotësisë Gjermane, të krijojmë, ne një bexh tonin, dhe ju nga përvojat e fituara



të vlerësoni se cilat cilësi t'i vendosim, ne si standarde".Ndërsa, gjenerali Dietmar Mosmann, tha: "Në Gjermani bexhi i zotësisë është traditë, dhe tek ne, thuhet se deri në tri herë kurë përsëritet një aktivitet është standard, por pas tri herëve, bëhet shprehi. Shpresoj se edhe bexhi i zotësisë tek ju të bëhet shprehi. Në Gjermani çdo vit secilit ushtarë i mundësohet të garojë në bexhin e zotësisë, me standardet të cilat janë të caktuara për këtë bexh.

Nga tetëmbëdhjetë pjesëtarët e FSK-së, të cilët u kualifikuan nga kjo garë; 8 prej tyre u pajisën me Bexhin e Artë, 9, me Bexhin e Argjendtë dhe 1 me atë të bronztë. Për të marrë njërin prej bexheve; pjesëtarët iu nënshtruan dhe kaluan me sukses disiplinat: Testi Bazik i Fitnesit; Not 100 metra me uniformë; Testi i ndihmës së parë (shpëtimi i jetës në betejë; Testi MKAB-së; Qitje me revole dhe Marshimi rrugor.

Kjo është hera e dytë, që kjo garë realizohet në FSK, dhe garat u mbajtën në ambientet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në Poligonin e qitjes në Rahovec dhe Pishinën në Milloshevë. Të pranishëm në ceremoninë e certifikimit ishin: Zëvendës komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Dietmar Mosmann, komandanti i Kontingjentit Gjerman të KFOR-it, kolonel Johen Gumprih, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, zëvendës komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale kolonel Avdi Rraci, komandanti i Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, nënkolonel Sylejman Caka, si dhe oficerë dhe nënoficer të FSK-së.

KFOR-i dhe FSK-ja ndihmojnë shkollën fillore në Sushicë të Graqanicës

KFOR-i në bashkëpunimi me Departamentin për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të Ministrisë për FSK-në, (CIMIC), janë angazhuar në rregullimin e rrjetit të kanalizimit në shkollën e fshatit Sushicë komuna e Graqanicës, fshat i banuar me popullatë shqiptare dhe serbe. Kërkesa është identifikuar nga CIMIC-u, KFOR-i dhe më pas është vlerësuar nga DBCU e MFSK-së. Kurse, Batalioni i Xhenios i FSK-së, më 12 korrik 2017, është angazhuar në realizimin e projektit një ditore; në hapjen dhe mbylljen e kanalit në gjatësi prej 30 m, në oborrin e kësaj shkolle në fshatin Shushice të Graqanices. Tubacioni i prishur i kanalizimit ka shkaktuar një ambient jo të shëndoshë dhe të rrezikshëm për fëmijët e këtij lokaliteti, që nga janari i këtij viti. Prandaj JRDC, përmes Ekipit slloven Ndërlidhës të Monitorimit, FSK-së dhe komunës së Graqanicës ka blerë gypin dhe siguruar ekipin teknik për instalim. Aktivitetet e FSK-së, janë në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe etnive, në mënyrë të paanshme dhe me respektin më të thellë për kulturat e ndryshme dhe besimet fetare.



FORCA JONË

□□□ Viti VI □ Nr. 61 □Tetor 2017 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Rrustem Berisha

Ministër i ri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, sot (11.09.2017) zyrtarisht u bë dorëzimi-pranimi i detyrës së ministrit të MFSK-së. Ministri i deritashëm z. Demolli, me këtë rast, i uroi detyrën e ministrit Rrustem Berishës duke i dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në drejtimin e MFSK-së. Ai e njoftoi ministrin e porsazgjedhur me të arriturat e deritashme të FSK-së, si dhe me projektet të cilat janë në vazhdim. Gjithashtu, z. Demolli ka falënderuar gjithë stafin e ministrisë dhe FSK-së, për bashkëpunimin e suksesshëm gjatë rrugëtimit të përbashkët në ndërtimin dhe zhvillimin e MFSK-së dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Nga ana e tij, ministri i ri, z. Berisha pasi pranoi detyrën, falënderoi ministrin Demolli duke e përgëzuar për sukseset që ka shënuar kjo forcë, dhe njëherësh konfirmoi përkushtimin e tij për të vazhduar me angazhim maksimal në drejtimin dhe realizimin e detyrave dhe projekteve të përgjithshme për Ministrinë dhe FSK-në. Në ceremoni ishin të pranishëm edhe zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjenerali Gëzim Hazrolli, drejtori për Politika dhe Plane, Faruk Geci, drejtori dhe zv. drejtori i NALT-it (Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për FSK-në), gjeneral brigade Dietmar Mosmann dhe z. Mark Theobald, koloneli Fadil Hadërgjonaj, këshilltari ushtarak dhe shefi i Kabinetit Latif Leka.





Ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha u prit nga ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta Xhaçka

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Rrustem Berisha me ftesë të ministres së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, znj. Olta Xhaçka, më 26.09.2017, qëndroi për një vizitë zyrtare në Tiranë. Ministri Berisha dhe delegacioni i Ministrisë për FSK u prit në Ministrinë e Mbrojtjes me ceremoni ushtarake.

(Vijon në faqe 4)

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama qëndroi për vizitë zyrtare në Forcat e Armatosura të Turqisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të komandantit të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneral Hulusi Akar, më 27.09.2017, qëndroi për vizitë zyrtare në Ankara. Gjeneral Rama, në Ankara, u prit me nderime ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë nga Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë së Turqisë, gjeneral Hulusi Akar. Të dy komandantët, gjatë takimit, kryesisht biseduan për marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimin e suksesshëm dypalësh në mes FSK-së dhe FAT-it si dhe për planet e bashkëpunimit në të ardhmen. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, vlerësoi lartë mbështetjen që Ushtria turke është duke dhënë në të gjitha fushat për FSK-në, në mënyrë që FSK-ja të vazhdojë zhvillimin dhe profesionalizimin e saj të gjithanshëm. Ai njëherësh nënvizoi përkushtimin e Komandantit të Forcave të Armatosura të Turqisë gjeneralit Akar për mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së në pajisje dhe në fushën e arsimit dhe trajnimit profesional. Më tej, gjeneral Rama vizitoi muzeun ,,Kemajl Ataturk"në Ankara, dhe i përcjellë nga ceremonia ushtarake vendosi kurora lulesh pranë varrit të themeluesit të Turqisë moderne Kemajl Ataturk. Gjeneral Rrahman Rama dhe delegacioni i MFSK-së, në përbërje: Sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, sekretari personal i SP, Florin Hoxha, shefi i Sektorit për



Plane, Programe dhe Analiza, nënkolonel Sefer Isufi, atasheu i FSK-së i akredituar në Turqi, nënkolonel Bekim Osmani dhe asistenti ushtarak i komandantit të FSK-së, kapiten Jaser Mulla, më pas vizituan disa nga repartet e industrisë ushtarake turke, ku panë nga afër disa nga pajisjet më moderne ushtarake individuale dhe kolektive, që mund të jenë me interes për FSK-në. Vizita e komandantit të FSK-së dhe delegacionit në tërësi po realizohet në kuadër të vazhdimësisë së bashkëpunimit dypalësh në mes të FSK-së dhe Ushtrisë turke.

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha priti në takim ambasadorin e SHBA-ve Greg Delawie

Ministrit i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, ka pritur më 12.09.2017 në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, z. Greg Delawie. Ministri Berisha e falënderoi ambasadorin për vizitën dhe urimin që i bëri për detyrën e re. Ai me këtë rast, ka falënderuar ambasadorin Delawie, për bashkëpunimin dhe ndihmën e vazhdueshme që SHBA-të kanë dhënë për Ministrinë dhe FSK-në, duke theksuar se ai do të punojë për ta thelluar këtë bashkëpunim edhe më tepër gjatë mandatit të tij. Ai foli edhe për rëndësinë e procesit të transformimit të FSK-së në FAK dhe sfidat që e presin këtë proces, duke theksuar se ai do të përcjellë mesazhin e qartë dhe të hapur te komuniteti serb dhe komunitet tjera, se FAK-u nuk do të jetë i orientuar kundër askujt, por do të jetë në interes të gjithë qytetarëve të Kosovës. Nga ana e tij, ambasadori i SHBA-ve Greg Delawie, shprehi gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin edhe në të ardhmen duke theksuar se ambasada e SHBA-ve mirëpret gatishmërinë për të vazhduar këtë bashkëpunim për të shtuar dhe forcuar kapacitet e FSK-së. Ne e përkrahim transformimin e FSK-së në FAK të bazuar në ndryshimet kushtetuese dhe vlerësojmë se ky proces duhet të jetë gjithëpërfshirës për të gjithë komunitetet dhe ti kontribuojë stabilitetit rajonal. Takimi me ambasadorin e SHBA-ve ishte takimi i parë i ministrit Berisha në detyrën e re, takim i cili kaloi në atmosferë miqësore shumë të mirë.



Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralin Giovanni Fungo

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Rrustem Berisha priti sot, për herë të parë në takim, komandantin e KFOR-it, gjeneralin Giovanni Fungo. Në takimin e ministrit Berisha dhe gjeneralit Fungo u bisedua për situatën e sigurisë në vendin tonë dhe gjithashtu për bashkëpunimin e mirë ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Trupave Paqeruajtëse të KFOR-it, si dhe për planet dhe aktivitetet konkrete për bashkëpunim në të ardhmen. Me këtë rast, ministri



Berisha u shpreh se, gjatë mandatit të tij do të angazhohet që t'i avancojë më tutje marrëdhëniet e shkëlqyera të kultivuara deri më tani në mes të Ministrisë për FSK dhe KFOR-it. Po ashtu, ministri Berisha tha se, krahas zhvillimit dhe avancimit të FSK-së është duke u punuar edhe në planin për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur, dhe se kjo do të bëhet me konsensus të plotë me faktorin e brendshëm dhe në bashkëpunim me partnerët strategjikë, duke qenë transparent në çdo hap të procesit. Nga ana e tij, komandanti i Trupave Paqeruajtëse të KFOR-it, Giovanni Fungo tha se, KFOR-i dhe FSK-ja kanë raporte bashkëpunimi shumë konkrete, jo vetëm me takime e shkëmbime zyrtare por edhe me ushtrime dhe aktivitete tjera të përbashkëta fushore, në të cilat njësi të veçanta të KFOR-it dhe të FSK-së po kryejnë stërvitje të përbashkëta. Në fund, gjenerali Fungo njoftoi se, janë në prag të përfundimit të procesit të planifikimit për disa aktivitete konkrete të përbashkëta, të cilat do të realizohen në bashkëpunim KFOR-FSK, dhe se, bashkëpunime të tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama priti një delegacion të Lordëve nga Britania e Madhe

Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, një delegacion i përfaqësuesve të zgjedhur të Komitetit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Shtëpisë së Lordëve të Britanisë së Madhe, i kryesuar nga Lordi Bruce Grocott, Baronesha Elizabeth Coussins të shoqëruar nga: Keneth Marrison, Roshani Palamakumbura dhe Sam Paice, më 20.09.2017 u pritën nga komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama me bashkëpunëtorë. Me këtë rast, komandanti i FSK-së gjeneral Rama e njoftoi delegacion e Britanisë së Madhe me zhvillimet e përgjithshme të FSK-së, me sukseset dhe të arriturat e përgjithshme të FSK-së, duke theksuar se "në sukseset tona është edhe kontributi i Anglisë", për çka komandanti falënderoi Qeverinë dhe Forcat e Armatosura të Britanisë së Madhe. Gjithashtu, gjeneral Rama i njoftoi mysafirët rreth organizimit të brendshëm të FSK-së, pjesëmarrjen e FSK-së në trajnime ndërkombëtare, shkollimin e kadetëve dhe pjesëtarëve të FSK-së në akademitë ndërkombëtare prestigjioze, në vende të ndryshme mike dhe posaçërisht ato të Britanisë së Madhe, ku pjesëtarët e FSK-së kanë treguar arritje të larta duke marrë edhe medalje ari. Komandanti i FSK-së, mysafirët i njoftoi edhe me misionin e tanishëm të FSK-së, përgatitjet për transformimin e FSK-së, për vështirësitë nëpër të cilat po kalon ky proces. Ai foli edhe për shkallën e bashkëpunimit në rajon dhe posaçërisht me vendet fqinje, duke u angazhuar që mos të jemi vetëm konsumues të sigurisë por edhe prodhues të saj. Duke folur për bashkëpunimin e mirë me KFOR-in dhe Ekipet Këshilluese Ndërlidhëse të NATO-s, ngritjen dhe trajnimin e FSK-së me standarde të NATO-s, ne natyrshëm synojmë dhe angazhohemi që Kosova të jetë pjesë e NATO-s dhe si shoqëri të jemi pjesë e botës euroatlantike. Ndërsa në emër të delegacionit të Lordëve nga Britania e Madhe, falënderoi për pritjen, Lordi Krokot, i cili përveç tjerave u interesua të dijë më shumë rreth integrimit të pjesëtarëve të komuniteteve në kuadër të FSK-së, kurse Baronesha Cousins për sigurinë e përgjithshme dhe për ndihmën e ndërkombëtarëve në përgatitjet për transformimin e FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i njoftoi mysafirët, rreth përfaqësimit në nivel të lartë të pjesëtarëve të komuniteteve në kuadër të FSK-së, që aktualisht është 10.5%, integrimin e suksesshëm të pjesëtarëve të komunitetit serb. Delegacioni i Lordëve nga Britania e Madhe u ndanë të kënaqur me pritjen dhe me arritjet e përgjithshme të FSK-së, sidomos me përfshirjen dhe në integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në FSK. Në këtë takim, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, shoqërohej nga gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Departamentit të Operacioneve, drejtori i Drejtorisë Politike z. Faruk Geci, nënkoloneli i Britanisë së Madhe Gregor Lindsay, këshilltar ushtarak i Komandantit të FSK-së dhe kolonel Jeton Dreshaj këshilltar i Komandantit.





FSK-ja përkujton 11 shtatorin e sulmeve terroriste në SHBA

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës përkujtuan viktimat e 11 shtatorit të vitit 2001, të sulmeve terroriste mbi popullatën amerikane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më 11 shtator 2017, në të gjitha njësitet e FSK-së, me organizime të ndryshme u nderuan viktimat e sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Po ashtu edhe në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, pjesëtarët e FSK-së së bashku me pjesëtarët amerikanë të kampit Bonstill, edhe këtë vit, si çdo vit tjetër, përkujtuan me nderim viktimat e sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe i tërë populli i Kosovës ndajnë dhimbjen me popullin amerikan, i cili në çdo vend të botës kontribuon për paqe e liri.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Rrustem Berisha priti përfaqësuesit ushtarak të ambasadës së SHBA-ve në Kosovë



Sot (15.09.2017) ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, zoti Rrustem Berisha, i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, këshilltari ushtarak i ministrit kolonel Fadil Hadegjonaj dhe shefi i Kabinetit të ministrit Latif Leka, priti një delegacion të gjerë të përfaqësuesve ushtarak të ambasadës së SHBA-ve në Kosovë. Delegacioni kryesohej nga kolonel Xhefri Fisher, atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-ve, në Prishtinë, i cili shoqërohej nga; major Juan Murillo, atashe ushtarak i Ambasadës së SHBA-ve, Joshua Rubin, këshilltar për çështje politike-ushtarake, Brian Devlin, shefi i Zyrës për Bashkëpunim Ushtarak (ODC) dhe Jodi Marti, oficerë përfaqësues në Ambasadën e SHBA-ve, në Prishtinë. Qëllimi i vizitës ishte që t'i uronin ministrit detyrën e re, dhe ta njoftonin më për së afërmi me detyrat që kryejnë në raport me MFSK-në dhe FSK-në. Ministri Berisha shprehu kënaqësinë për vizitën e bërë, duke i falënderuar për urimin dhe posaçërisht duke i falënderuar për kontributin e tyre konkretë dhe të SHBA-ve për Kosovën dhe ngritjen e FSK-së. Ai vlerësoi angazhimet dhe kontributet e tyre personale në ngritjen dhe thellimin e bashkëpunimit të ngushtë mes MFSK-së dhe Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë posaçërisht të personelit të saj ushtarak. Ai po ashtu vlerësoi lartë bashkëpunimin shumë intensiv me Gardën Kombëtare të Ajovës dhe FSK-së. Ministri shprehi bindjen se edhe në të ardhmen të gjitha sfidat do ti tejkalojmë duke bashkëpunuar dhe koordinuar ngushtë me partnerin tonë strategjik - SHBA-të. Ministri shprehi bindjen se edhe për transformimin e FSK-së në FAK do të bashkëpunojmë ngushtë deri sa të arrihet te vendimi politik për transformim. Po ashtu e dhe Komandanti i FSK-së, në fjalën e tij shprehi falënderimet për përkrahjen e SHBA-ve dhe kontributin konkretë të oficerëve të pranishëm. Ai vlerësoi se bashkëpunimi është shumë i mirë dhe shumë intensiv, duke përmendur me theks të veçantë bashkëpunimin me Gardës Kombëtare të Ajovës dhe kontributin e madh të vet komandantit të saj, gjeneralit Timothy Orr. Ky bashkëpunim ka dhënë rezultate konkrete, si në fushat e trajnimit ashtu edhe në ushtrime fushore të përbashkëta. Nga ana e tij, koloneli Fisher, pasi uroi edhe një herë ministrin Berisha për detyrën e re, vlerësoi lartë punën dhe bashkëpunimin e deritashëm me FSK-në. Ai shprehi konsideratat e tij për ministrin duke theksuar se ndjehet mirë që për çështjet kryesore; si çështja e transformimit, kemi qasje të ngjashme. Gjithashtu koloneli Fisher vlerësoi lartë shkallën e bashkëpunimit me FSK-në, si: në fushën e trajnimeve, shkollimit, ushtrimeve dhe donacioneve që po jepen për FSK-në si dhe vlerësoi lartë arritjet e kadetëve dhe ushtarëve të FSK-së, në ushtrimet dhe shkollimet ndërkombëtare, ku janë shquar për vendosmërinë dhe kualitet e tyre, duke dalë më të mirët, dhe duke u nderuar me medalje. Në fund koloneli Fisher shprehu gatishmërinë për thellimin e këtij bashkëpunimi me përkrahjen e vazhdueshme që do ketë ministri në punën e tij dhe bashkëpunimin me FSK-në. Të gjithë mysafiret, shprehen kënaqësinë e tyre për punën dhe kontributin, si dhe për bashkëpunimin në mes FSK-së dhe ambasadës së SHBA-ve, në Kosovës dhe ushtrinë amerikane dhe Shtet e Bashkuara të Amerikës.



Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha priti në takim ambasadoren e Turqisë, znj. Kivilcim Kiliç

Ambasadorja e Republikës së Turqisë në Kosovë, znj. Kivilcim Kiliç ka qëndruar sot (14.09.2017) për një vizitë pune në mjediset e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ku është pritur nga ministri Rrustem Berisha. Ministri Berisha fillimisht falënderoi ambasadoren Kiliç për vizitën dhe urimin që ajo i bëri me rastin e angazhimit të tij në detyrën e re, dhe njëherësh përmes saj falënderoi Republikën e Turqisë për bashkëpunimin dhe ndihmën e vazhdueshme që ajo ka dhënë dhe po vazhdon të japë për FSK-në. Gjithashtu, ministri i FSK-së kërkoi nga ambasadorja Kiliç vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen në të gjitha fushat me interes të përbashkët për të dyja ministritë dhe të dyja vendet. Ndërkaq, nga ana e saj, edhe ambasadorja e Turqisë, znj. Kiliç, shprehi gatishmërinë për thellimin dhe vazhdimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen në mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë.

Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli priti në takim lamtumirës zv. Komandantin e KFOR-it dhe zv. shefin e NALT-it

Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, priti në takim lamtumirës zëvendëskomandantin e KFOR-it, gjeneralin Christian Riener me bashkëpunëtorë. Gjatë takimit, gjeneral Hazrolli falënderoi gjeneralin Riener për kontributin e dhënë jo vetëm në Forcën e Sigurisë së Kosovës, por edhe në sigurinë e vendit në përgjithësi. Gjeneral Hazrolli tha se, gjatë shërbimit në FSK, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Riener, ofroi ndihmën dhe përvojën e tij profesionale në organizimin e ushtrimeve të përbashkëta me KFOR-in, si te ,,Shpata e Argjendtë", po ashtu përmes trajnimeve të ndryshme ndihmoi në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Gjenerali Riener u shpreh i kënaqur më bashkëpunimin dhe të arriturat e pjesëtarëve të FSK-së dhe falënderoi gjeneral Hazrollin për një bashkëpunim siç tha ai; të shkëlqyer, duke shpresuar që bashkëpunime të tilla, në të mirë të FSK-së, nuk do të mungojnë edhe në të ardhmen.
Gjithashtu, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli më 13.09.2017, priti në një takim lamtumirës edhe zëvendësshefin e Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s në FSK, kolonelin turk Ilyas Altikanoglu. Me këtë rast, gjeneral Hazrolli e falënderoi kolonelin Ilyas për angazhimin dhe kontributin e treguar gjatë periudhës së shërbimit të tij në FSK, duke i uruar gjithë të mirat si në punë ashtu edhe në familje. Ai gjatë fjalës së tij, të mbajtur me këtë rast, vlerësoi lart mbështetjen e madhe dhe të pakursyer të kolonelit Ilyas dhe të shtetit turk për FSK-në në të gjitha fushat, si në trajnime, pajisje dhe mbështetje strategjike. Ndërsa, koloneli turk shprehu falënderimin e tij ndaj gjeneral Hazrollit dhe FSK-së në përgjithësi për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që patën ndërmjet veti, duke nënvizuar se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje në mbështetjen, ngritjen dhe profesionalizmin e FSK-së.





FORCA JONË

Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha u prit nga ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta Xhaçka



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Rrustem Berisha me ftesë të ministres së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, zonjës Olta Xhaçka qëndroi për një vizitë zyrtare në Tiranë. Ministri Berisha dhe delegacioni i Ministrisë për FSK u pritën në Ministrinë e Mbrojtjes me ceremoni ushtarake. Në takimin e përbashkët të ministrit Berisha dhe ministres Xhaçka dhe të delegacioneve të tyre u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe shtetërore si dhe për bashkëpunimin e suksesshëm në mes dy ministrive. Fillimisht, ministri Berisha e uroj ministren Xhaçka për detyrën e re, duke i shprehur edhe besimin e palëkundur se të dy ministritë dhe dy shtetet tona do të vazhdojnë zhvillimin e marrëdhënie të shkëlqyera dhe do të intensifikojnë bashkëpunimin mes tyre në të ardhmen. Më tej, ministri Berisha tha:,,Karakteri i kësaj vizite ishte më tepër njoftues dhe ka për qëllim ta zgjerojë bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes dhe kjo është në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit rajonal të të gjitha vendeve të rajonit". Gjithashtu, ministri Berisha shtoi: ,,Republika e Kosovës synon që të promovojë raportet e mira fqinjësore me të gjitha shtetet e rajonit. Jo vetëm për të minimizuar kërcënimet dhe rreziqet, por edhe për të tejkaluar trashëgiminë e së kaluarës, sepse në këtë rajon kemi pasur një trashëgimi jo fortë të mirë dhe shpresojmë se do të gjejmë mënyra dhe forcë qe t'i tejkalojmë të gjitha barrierat, të cilat do të rrezikojnë sigurinë e brendshme, sigurinë rajonale dhe sigurinë globale". Ministri Berisha, gjatë vizitës së tij, me theks të veçantë foli për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. ,,E njoftova ministren se Qeveria e Republikës së Kosovës një ndër prioritet e saj ka edhe forcimin e institucioneve të sigurisë. Në kuadër të saj është edhe transformimi i Forcës së Sigurisë në Forca të Armatosura të Kosovës".Në fund, ministri Berisha tha se ,,ne synojmë që bashkëpunimin e mëhershëm ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes ta avancojmë edhe më tej. Deri më tani kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyer sidomos në fushën e arsimimit dhe trajnimeve, ku janë organizuar kurse të ndryshme, që nga kursi bazik deri në kursin e avancuar. Presim nga Ministria e Mbrojtjes që të kemi përkrahje dhe mbështetje për anëtarësim në iniciativa rajonale dhe integrimin në NATO, dhe besojmë që pas këtij takimi njoftues ministrja Xhaçka në agjendën e saj do të parashohë një vizitë në Kosovë, konkretisht në Ministrinë e Forcës për Sigurinë e Kosovës". Ndërsa, ministrja Xhaçka u shpreh se takimi ishte një mundësi e shkëlqyer për ta uruar zotin Berisha për detyrën e re në krye të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke shtuar: ,Jam e bindur se zoti ministër, por edhe Qeveria e re e Republikës së Kosovës e drejtuar nga zoti Haradinaj do të vijojnë punën e shkëlqyer për integrimin e vendit të tyre në strukturat euro-atlantike". Më tej, ministrja shqiptare e Mbrojtjes theksoi: ,,E sigurova zotin ministër se mbështetja jonë do të vijojë të jetë konkrete dhe maksimale si në rrafshin politik ashtu edhe në atë teknik. E gjithë eksperienca e Shqipërisë në rrugën e integrimit të plotë në NATO do të vijojë të përcillet me profesionalizëm dhe me dashamirësi tek vëllezërit tanë kosovarë". Gjithashtu, ministrja Olta Xhaçka tha se Aleanca më e madhe ushtarake e botës, një bashkim vlerash dhe përpjekjesh në mbrojtje të jetës, lirisë dhe demokracisë së popujve të shteteve anëtare, e ka prioritet të qartë politikën e "dyerve të hapura" të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Si dhe integrimi i plotë i Ballkanit në NATO, do të thotë më shumë siguri, më shumë stabilitet, më shumë demokraci, jo vetëm për vendet anëtare, por edhe për Aleancën në tërësi. Për më tepër integrimi është një ëndërr e përbashkët e popujve të Ballkanit, të cilët meritojnë të shpërblehen për sakrificat e tyre. Në fund, ministrja shqiptare e Mbrojtjes tha: ,,I shpreha zotit ministër, bindjen time se, Republika e Kosovës, me ndihmën e pakursyer të vendeve aleate dhe atyre partnere, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të saj, do të realizojë shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcë të Armatosur të saj", përfundoj ministrja Xhaçka. Ndërkaq, ministri i FSK-së, zotëri Rrustem Berisha, gjeneral brigade Bashkim Jashari, shef i Inspektoratit të FSK-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, shef i Departamentit për Operacione dhe Trajnime, drejtori i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, z. Ibrahim Shala, këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Fadil Hadergjonaj dhe shefi i kabinetit të ministrit, z. Latif Leka, si dhe atasheu i Mbrojtjes të Republikës së Kosovës i akreditуar në Tiranë, nënkolonel Enver Dugolli, zhvilluan një takim me oficerët të cilët aktualisht janë duke u shkolluar dhe specializuar në institucionet ushtarake shqiptare. Më pas, ministri Berisha dhe delegacioni i FSK-së të shoqëruar nga zëvendësministri shqiptar i Mbrojtjes, z. Petro Koçi dhe oficerë të lartë shqiptarë vizituan edhe Batalionin e Forcave Speciale në Zall Herr të Tiranës.



Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha priti ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Ruairi O'Connell

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Rrustem Berisha priti në takim, ambasadorin fuqiplotë të Mbretërisë së Bashkuar, z. Ruairi O'Connell. Në takimin e përbashkët ministri Berisha dhe ambasadorit O'Connell biseduan lidhur me marrëdhëniet e shkëlqyera dhe bashkëpunimin e frytshëm ndërmjet Ministrisë për FSK dhe Ministrisë së Mbrojtjes si dhe FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, duke u zotuar për vazhdimin, avancimin dhe intensifikimin e këtyre marrëdhënieve në të ardhmen. Me këtë rast, ministri Berisha e njoftoi ambasadorin Ruairi O'Connell për vizionin e tij politik dhe të lidershipit të Ministrisë dhe Forcës për të ardhmen, duke i shprehur mirënjohjen për mbështetjen që Qeveria dhe populli britanik ka dhënë për FSK-në me zotimin se e ardhmja e FSK-së dhe planet për zhvillimin e Forcës do të bëhen në koordinim të plotë me partnerët strategjikë dhe me NATO-n. Ministri Berisha, foli gjithashtu edhe për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur, duke u shprehur se procesi i transformimit të FSK-së në FAK do të jetë plotësisht transparent dhe në koordinim të plotë me NATO-n dhe partnerët strategjikë, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar etj., si dhe



do të punohet ngushtë me të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të të gjitha komuniteteve, për t'i bindur ata, se Forca e Armatosur e Kosovës do të jetë Forcë e cila garanton sigurinë e Kosovës dhe popullit të saj pa dallim. Nga ana e tij, ambasadori O'Connell duke uruar ministrin Berisha për detyrën e re, u shpreh se marrëdhëniet e mira ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës së Kosovës do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, e gjithashtu edhe marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet ministrive dhe dy Forcave tona. Ndërsa atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Maqedonisë i akreditуar edhe për Kosovë, nënkolonel Richard Perry, i cili gjatë takimit u fokusua në fushat konkrete të bashkëpunimit në mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës së Kosovës.

Rekrutët e rinj të FSK-së betohen për shërbim ndaj Atdheut

Me një ceremoni madhështore në kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, më 29.09.2017, solemnisht, nën intonimin e himnit shtetëror u betuan 16 rekrutët e rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK),"Gjenerata 2021", të cilët filluan shkollimin për kadetë në Qendrën për Studime Universitare(QSU). Fillimisht, para të pranishmëve; mysafirë, ushtarakë e familjarë të rekrutëve, revistën e kadetëve të QSU të FSK-së të rreshtuar për ceremoninë e betimit e zhvilloi komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi. Rekrutëve të rinj-oficerëve të ardhshëm, të cilët kanë zgjedhur që t'i shërbejnë vendit, iu drejtua komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këto fjalë: "Ju falënderoj që iu keni bashkuar familjes sonë, në misionin e përbashkët. Ju siguroj që jeni duke bërë gjënë më fisnike që mund ta bëni, të përgatiteni për mbrojtën e qytetarëve tanë, për ruajtjen e vlerave demokratike dhe për të kontribuar për një botë më të mirë për fëmijët tanë".Gjeneral Rama në vazhdim tha se profesioni i oficerit nuk është i lehtë. Por, me disiplinë, vullnet, integritet dhe dëshirë, duke sfiduar vetën tuaj, do të arrini të korni suksese gjatë shkollimit dhe gjatë karrierës, duke i bërë krenarë familjen dhe institucionin. Më tej, komandanti i FSK-së tha; ,,Ne nuk duhet të vetëkënaqemi, por të punojmë shumë dhe me profesionalizëm e të mos dorëzohemi para sfidave që na shfaqen. Si shoqëri kemi avancuar shumë në ngritjen e kapaciteteve tona, por kemi edhe shumë punë për të bërë. I tërë ky rrugëtim është bërë falë bashkëpunimit dhe mbështetjes nga aleatët dhe partnerët tanë, sidomos nga SHBA-të". Gjithashtu, gjeneral Rama foli edhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura: ,,Tani jemi para një sfide tjetër; transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura. Ky proces është tërësisht në duart e liderëve tanë politikë, të cilët jam i bindur që do të gjejnë mënyrën më të mirë të vendimmarrjes strategjike". Në fund të fjalës së tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama porositi kadetët e rinj:



,,Gjatë katër viteve të ardhshme ju do të edukoheni, zhvilloheni dhe trajnoheni si udhëheqës, por në asnjë mënyrë mos bëni kompromis me detyrën, nderin dhe atdheun. Respektimi i vlerave dhe standardeve do t'ju bëjë persona më të mirë në ushtri, në familje dhe në shoqëri". Gjatë këtij aktiviteti të pranishmëve iu drejtua edhe komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili bëri një paraqitje në retrospektive të shkollimit të kadetëve: ,,Qendra për Studime Universitare tanimë ka bërë një traditë në edukimin e oficerëve të rinj, me rezultatet e së cilës krenohemi të gjithë. Tashmë, në Forcën e Sigurisë së Kosovës numërojmë gjithsejtë 105 oficerë të promovuar nga kjo qendër, të cilët janë duke bërë punë të shkëlqyera nëpër njësitë e tyre".Më tej, gjeneral Cikaqi iu drejtua kadetëve të sapo betuar me këto fjalë: "Betimi që bëtë sot, iu obligon me përgjegjësi të reja të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë në jetën tuaj, në familjet tuaja dhe në raport me FSK-në". Në fund të fjalës së tij, komandanti i KDS-së përgëzoi lidershipin e QSU-së, oficerët dhe nënoficerët që punojnë me kadetë, sepse siç tha gjenerali atyre u është besuar e ardhmja e oficerëve e rrjedhimisht edhe e ardhmja e lidershipit të Forcës tonë. Në fund rekrutët, kadetët e vitit të parë të studimeve, para oficerëve, familjarëve dhe mysafirëve të tjerë dhanë betimin dhe nënshkruan kontratën e shërbimit në FSK. Këtë vit janë pranuar dhe kanë filluar vitin akademik 16 rekrutë të rinj, prej tyre dy janë nga Republika e Shqipërisë. Kjo gjeneratë pritet të mbaroj studimet në vitin 2021.

Ministri Rrustem Berisha priti në takim ambasadoren e Kroacisë, Marija Kapitanoviq

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Rrustem Berisha priti sot, në takim, ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, znj. Marija Kapitanoviq. Gjatë takimit u bisedua për marrëdhëniet e mira ndërshtetërore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë, me theks të veçantë për marrëdhëniet e mira në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, përkatësisht Forcave të Armatosura të Kroacisë. Ministri Berisha, fillimisht, e njoftoi ambasadoren kroate me gjendjen e trashëguar aktuale në MFSK/FSK të cilën ministri e vlerësoi si të suksesshme, planet për të ardhmen rreth zhvillimit dhe avancimit të FSK-së si dhe planet për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Ministri Berisha rreth transformimit tha se, krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës është në interes të të gjithë qytetarëve të vendit, dhe se MFSK/FSK po punon fort që transformimi të gjejë përkrahje dhe konsensus të plotë brenda vendit si dhe të përkrahet edhe nga partnerët strategjikë me të cilët do të jemi plotësisht në koordinim, të hapur dhe në një transparencë të plotë.



Nga ana e saj, ambasadorja Kapitanoviq, pasi që i uroi ministrit detyrën e re, u shpreh se institucionet e Republikës së Kosovës tanimë janë të njoftuara me qëndrimet e shtetit kroat. Pra, siç tha ambasadorja Kapitanoviq, Kroacia dhe Kosova bashkëpunimin më të suksesshëm e kanë në fushën e sigurisë, pra bashkëpunimi MFSK-Ministri e Mbrojtjes së Kroacisë është në nivelin më të lartë. Ky bashkëpunim i suksesshëm do të vazhdojë edhe në të ardhmen, tha ambasadorja Kapitanoviq, dhe se fushat e bashkëpunimit do të zgjerohen duke qenë se tanimë kemi shkëmbime që kanë traditë, si në fushën e arsimit, trajnimeve profesionale, pjesëmarrjes në ushtrime ndërkombëtare etj. Bashkëpunimin e mirë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, në takimin e ministrit Berisha dhe ambasadores Kapitanoviq, e konfirmoi edhe atasheu i Mbrojtjes së Kroacisë në Shkup i akreditуar për Kosovë, kolonel Marijana Cadonic.

Ministri Rrustem Berisha priti ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Sardi

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Rrustem Berisha priti sot në takim ambasadorin fuqiplotë të Republikës së Italisë në Republikën e Kosovës, z. Piero Cristoforo Sardi me bashkëpunëtorë. Në takimin e përbashkët të ministrit Berisha dhe ambasadorit Sardi u bisedua për marrëdhëniet e mira ndërmjet Italisë dhe Kosovës, si dhe për bashkëpunimin e mirë dhe produktiv në mes të FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Italisë. Fillimisht, ministri Berisha shprehu falënderimin e tij për popullin dhe Qeverinë e Italisë për gjithë ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë për Kosovën, si dhe për kontributin e jashtëzakonshëm të kontingjenteve ushtarake në kuadër të KFOR-it, për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vendin tonë. Më tej, ministri Berisha e njoftoi diplomatin italian mbi zhvillimet në FSK dhe planet për të ardhmen, duke potencuar faktin se çështje imediate është transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura, për të cilën institucionet më të larta vendore marrin vendim, atëherë kur të arrihet konsensusi i plotë brenda vendit dhe koordinim me partnerët strategjikë dhe vendet mike të Republikës së Kosovës. Nga ana e tij, ambasadori Piero Sardi duke i uruar ministrit Berisha detyrën e re, konfirmoi qëndrimin e shtetit italian për vazhdimin e bashkëpunimit si dhe konkretizimin e tij me aktivitete dhe shkëmbime të përbashkëta.



Ambasada amerikane i dhuroi FSK-së pajisje komunikimi në vlerë prej 9.2 milionë dollarë

Në mjediset e kazermës "Adem Jashari" në Prishtinë, sot u organizua ceremonia e pranimdorëzimit të donacionit të pajisjeve ,,Harris", nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë për Kompaninë e Komunikimit, në vlerë 9.2 milionë dollarë amerikan. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësambasadorja amerikane në Kosovë Colleen Hylande, këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Fadil Hadergjonaj, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), kolonel Naim Haziri si dhe përfaqësueses nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë dhe eprorë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pjesëmarrësit e kësaj ceremonie u njohën nga afër më këto pajisje dhe me funksionin e tyre nga zëvendëskomandanti i Kompanisë së Komunikimit togeri Jeton Ahmeti dhe zëvendësambasadorja amerikane znj. Colleen Hylande, të cilët së bashku bënë disa komunikime të atypëratyshme, për t'i njoftuar të pranishmit për rolin dhe rëndësinë e këtyre pajisjeve, jo vetëm për Kompaninë e Komunikimit por edhe për FSK-në në përgjithësi. Me këtë rast, ministri i FSK-së z. Rrustem Berisha falënderoi Ambasadën amerikanë në Kosovë për bashkëpunimin dhe ndihmën e pakursyer në vazhdimësi për FSK-në. "Ky donacion për FSK-në është mjaft i rëndësishëm pasi që Forca bëhet moderne vetëm më pajisje të tilla moderne. Shpresojmë që në të ardhmen këtë sistem ta përdorim në komunikime të drejtpërdrejta me partnerët dhe aleatët tanë". Më pas, mysafirët vizituan edhe pjesëtarët e FSK-së, të cilët për t'u aftësuar në përdorimin e këtyre pajisjeve po ndjekin trajnimin e organizuar nga instruktorët amerikanë. Edhe gjeneral Rama nga ana e tij falënderoi zëvendësambasadoren amerikane dhe nëpërmjet saj Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë, për donacionin dhe mbështetjen e vazhdueshme që SHBA-të kanë dhënë



ndër vite për avancimin e FSK-së. Komandanti i FSK-së, ndër të tjera, foli edhe për rëndësinë e trajnimit që po ndjekin pjesëtarët e FSK-së. "Donacioni i sotëm ka rëndësi mjaft të madhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe po aq i rëndësishëm është edhe trajnimi të cilin e keni organizuar ju për aftësimin e pjesëtarëve tanë në përdorimin e mirëfilltë të këtyre pajisjeve. Ndërkaq, zëvendësambasadorja amerikane u shpreh e kënaqur me pritjen dhe me vlerësimin që iu bë donacionit nga ana e FSK-së, si dhe vlerësoi lart angazhimin e pjesëtarëve në trajnim, duke thënë se nuk mund të bëhet një përdorim i mirëfilltë i këtyre pajisjeve pa një trajnim të tillë dhe më vjen mirë që i shoh një disponim të tillë për t'i mësuar të gjitha gjërat. Vlen të theksohet se Ambasada amerikane ka mbështetur Forcën e Sigurisë së Kosovës në të gjitha fazat e zhvillimit si në pajisje ashtu edhe në trajnim për ngritjen profesionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Gjermania i dhuroi FSK-së laborator të gjuhës gjermane



Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, z. Muhamet Latifi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pritën më 5.09.2017, në vizitë zëvendësambasadorin e Gjermanisë në Republikën e Kosovës, z. Jan-Axel Voss. Zëvendësministri Latifi e falënderoi zëvendësambasadorin Voss, për ndihmat e vazhdueshme që Gjermania po jep për Kosovën dhe në kuadër të saj edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Z. Latifi përmes zv. ambasadorit Voss, falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat Ushtarake të Gjermanisë, të cilët po japin një kontribut të madh në profesionalizimin e FSK-së, përmes shkollimit, trajnimeve, pjesëmarrjes në ushtrime dhe seminare të pjesëtarëve të FSK-së dhe përmes donacioneve. Gjithashtu, zëvendësministri Latifi dhe gjeneral Rama, me këtë rast e njoftuan zv. ambasadorin Voss, edhe me zhvillimet dhe të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Nga ana e tij, zëvendës ambasadori gjerman Jan-Axel Voss, premtoi se do të angazhohet për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi të mirë, ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë. Pas takimit, në kazermën "Adem Jashari" u mbajt ceremonia e dorëzim-pranimit të laboratorit modern për mësimin e gjuhës gjermane për pjesëtarët e FSK-së. Në takim ishin prezent edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, atasheu ushtarak i Gjermanisë në Kosovë, kolonel Martin Herrmann dhe këshilltari gjerman për Logjistikë në MFSK-së, nënkoloneli Michael Gierse.

Holanda dhuroi për FSK-në, makineri qepëse

Qeveria e Holandës i dhuroi FSK-së, një donacion në vlerë prej 22 mijë eurove. Ceremonia e dorëzim-pranimit u mbajt në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së. Dorëzimin e këtij donacioni e bëri ambasadorja e Holandës, znj. Gerrie Willems dhe e pranoi ministri i FSK-së, Haki Demolli. Donacioni ka të bëjë me makina qepëse të trikotazhit dhe tapiceri me materiale përcjellëse të mirëmbajtjes. Kurse trajnimin profesional për përdorim të këtyre makinave, të pjesëtarëve të FSK-së, e ka mundësuar Qeveria e Gjermanisë përmes Forcave të Armatosura të saj. Në takim ishin prezent atasheu ushtarak i Holandës, nënkoloneli Theo Plijner dhe këshilltari gjerman për Logjistikë në MFSK-së, nënkoloneli Michael Gierse, të cilët dhanë kontribut për realizimin e donacionit për FSK-në. Ministri Demolli dhe ambasadorja Willems biseduan edhe për marrëdhëniet e mira ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Holandës, me theks të veçantë për bashkëpunimin e mirë ndërmjet dy ministrive të Mbrojtjes.



Pjesëtaret e FSK-së përgatiten për trajnim në SHBA

KFOR MULTINATIONAL BATTLE GROUP - EASToMONDAY, SEPTEMBER 4, 2017
Shkrim nga Kapteri i ushtrisë Amerikane Steven M. Colvin

KAMPI BONDSTILL, Kosovë; Dy pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës vizituan kampin Bondstill, më 8 gushtë 2017, si pjesë e programit përgatitës, para se të nisen për vend trajnimet e tyre në SHBA. Togeri Albert Asllani, oficer për operacione të sigurisë në komandën e forcave tokësore dhe nëntogeri Milosh Deniq, udhëheqës i togut të transportit patën mundësinë të bisedojnë me homologët e tyre nga ushtria amerikane, me qëllim të përgatiten sa më mirë për vizitën që do bëjnë në Amerikë. Dy oficerët e FSK do të shkojnë në Fort Gordon, Georgia dhe Fort Lee,Virgjinia, për të ndjekur kurset si oficer komunikimi dhe oficer logjistike. Ata u njoftuan më gjerë për të kuptuar qëllimin e kurseve individuale si dhe kulturën amerikane, që përfshijnë kushtet e jetës dhe ambientit. Asnjeri nga këta nuk ka qenë më parë në Amerikë, për vizitë ose për ndonjë lojë trajnimi. Të dy oficerët e FSK-së vizituan tërë kampin Bondstill, dhe po ashtu edhe objektin e postës, gjimnazin, kuzhinën, objektin për kalitje fizike dhe objekte tjera, për të pasur një ide të qartë se çfarë i pret ata kur të mbërrijnë në Fort Gordon dhe Fort Lee. "Qëllimi i vizitës sonë, ishte të ndërtojmë raporte të mira me Asllanin dhe Denicin si dhe me personelin e FSK-së," tha majori Christopher Evans, oficeri kryesor për komunikim në brigadën e lindjes, ekipi luftarak shumëkombësh. " E morën kampin Bondstill si shembull se çfarë lloji ambienti i pret kur të gjenden në hapësirat trajnuese të ushtrisë amerikane në SHBA. Programi njoftues i mundësoj Denicit të sheh nga afër se me çfarë lloji pajisje do të merret gjatë trajnimit të tij specifik ushtarak. Kapiteni James Culver, mentori i Denicit dhe oficeri për transport, divizioni lindje MNBG, e prezantoi Denicin tek CW2 Antonio Pouncy, oficer në detyrë për aktivitetet mbështetëse furnizuese në MNBG-lindje në kampin Bondstill. Pouncy i demonstroi disa procedura të lëshimit dhe porosive elektronike që mund të jenë pjesë e trajnimit të tij në Fort Lee. Denici do të mësojë shumë rreth procedurave të magazinimit dhe lëshimit të klasave të ndryshme të pajisjeve tha Culver. Si person përgjegjës për këtë fushë ai duhet të mësoj si të plotësojë saktësisht formularët për të kërkuar artikullin e duhur dhe që artikulli ka shkuar në adresën e duhur. "Trajnimi ishte i mirë sot, dhe me ndihmën e kap. Culver, unë tash e di çka të presë atje tha Denic. "Ai më ka mësuar shumë rreth procedurave të logjistikës, dhe unë tash e di që njohuria që do marr nga shkolla do më ndihmoj kur të kthehem në Kosovë. Sikurse Denic, edhe Asllani kishte mundësinë të mësojë rreth shkollimit të tij në Amerikë, nga togeri Christopher Young, zëvendësoficer për komunikim në MNBG-lindje. Yongu i tregoj disa pajisje taktike dhe të komunikimit Asllanit, pajisje këto që ai mund t'i shoh gjatë kursit për sinjale të karrierës së kapiteneve në Fort Gordon. Qëllimi i njoftimit ishte që t'i ofroj Asllanit një njohuri për kursin, dhe t'i ndihmoj atij për rrjedhën e trajnimit që ai do t'i nënshtrohet atje, tha Young. Në fund të ditës Asllani tha që vizita në kampin Bondstill ishte e frytshme dhe e ka përgatitur për trajnimin që do vijë. "Vizita ishte e dobishme sepse më njoftoi për kursin" tha Asllani. "Majori Evans dhe Togeri Young më mësuan shumë rreth asaj se çka do më pret atje. Kjo më ndihmon të planifikoj gjërat me kohë dhe të jap më të mirën nga vetja ime"



Pjesëtarë të FSK-së certifikohen Instruktor të Trajnimit Fizik në Britani të Madhe

Në Shkollën Ushtarake të Anglisë të Trajnimit Fizik, FSK sot pati dy arritje. Dy pjesëtarë të stafit të saj, u kualifikuan të suksesshëm si: instruktor të trajnimit fizik. Pjesëtarja e FSK-së Gentiana Karpuzi u bë e para femër ushtare jo angleze, që përfundoi tërësisht kursin e ushtrisë britanike, "Kursin e Instruktorëve të Trajnimit Fizik". Ky kurs rigoroz-tridhjetë (30) javor është i hapur vetëm për ushtarët më të mirë të ushtrisë së Britanisë të cilët dëshirojnë të specializohen në fushën e trajnimit fizik. Po ashtu edhe pjesëtari Emir Vllasa, ka përfunduar "Kursin e instruktorit të trajnimit fizik të të gjitha armëve". Në këtë kurs studentët mësojnë të ngritin programe të trajnimit fizik dhe të udhëheqin seanca të trajnimit në palestër. Për të përcjellë nga afër këtë ceremoni të certifikimit në Shkollën Ushtarake të Anglisë të Trajnimit Fizik, ishin të pranishëm edhe drejtor i Drejtorisë së Operacioneve në MFSK gjeneral brigade Zymer Halimi, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, kolonel Naim Haziri dhe ambasadori i Kosovës në Londër Lirim Greiçevci.



FSK-ja i dhuroi Entit Kombëtar të Transfuzionit mbi 544 doza gjak



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës, përfundoi aksioni i dhurimit vullnetar të gjakut, gjatë muajit gusht. Ky aksion tashmë është bërë tradicional dhe organizohet me moton: "Një pikë gjak për shpëtimin e një jete". Institucioni i FSK-së, bazuar në objektivat e Ministrit dhe Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë të përkushtuar edhe në realizimin e projekteve humanitare në ndihmë qytetarëve të vendit pa dallime, siç është edhe aksioni për dhurimin e gjakut, që pjesëtarët e FSK-së, këtij aksioni i përgjigjen me dëshirën më të madhe. Organizimin e aksionit vullnetar të dhurimit të gjakut e ka bërë Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në bashkëpunim me Departamentin e Mjekësisë të MFSK-së, dhe është realizuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës dhe të Kompanisë së Mjekësisë të FSK-së. FSK-ja ka një traditë të organizimit dhe të dhurimit vullnetar të gjakut, jo vetëm gjatë aksioneve të rregullta, por pjesëtarët e saj i përgjigjen edhe jashtë këtyre organizimeve; në mënyrë individuale, gjatë gjithë vitit japin gjak, çdo herë që qytetarët e Kosovës kanë nevojë për të. Aksioni për dhurimin vullnetar të gjakut në FSK, ka filluar më datë 07.08.2017 dhe ka përfunduar më 30.08.2017. Gjatë këtij afatit, edhe përkundër pushimeve verore, pjesëtarët e FSK-së dhe stafi civil, kanë dhuruar 544 doza gjak, të cilat do të jenë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Në MFSK u mbajt seminari me temën 'Lidershipi Strategjik'

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nga data 04-08 shtator 2017, u mbajt seminari "Lidershipi Strategjik". Ky seminar është realizuar në bazë të planit të Bashkëpunimit Bilateral me SHBA-të, organizuar dhe përkrahur nga Zyra për Bashkëpunim Ushtarak e Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë. Seminari është mbajtur nga ekspertë eminent të fushës përkatëse, si: Glen Grant, Vladimir Milenski të kryesuar nga Drthomas Young. Në seminar kanë marrë pjesë stafi më i lartë i Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, nga drejtorët e departamenteve të ministrisë si dhe komandantët e njësiteve të FSK-së, të nivelit gjeneral, kolonel dhe nënkolonel. Interesimi për përcjelljen e seminarit ka qenë shumë i madh, ku janë realizuar tema të karakterit profesional që kanë të bëjnë me udhëheqjen në periudha dhe situata të ndryshme, që përmes planifikimit dhe drejtimit strategjik të gjinden mënyrat e maksimalizimit të veprimeve me kosto sa më të ulët. Gjetjet e këtij seminari në fund ju prezantuan udhëheqjes së MFSK-së, si dëshmi e përvetësimit të teknikave vlerësuese të menaxhimit strategjik. Në përmbyllje të seminarit mori pjesë sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Shkëlzen Sylaj dhe zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i Drejtorisë Politike zoti Faruk Geci, përfaqësuesit e Zyrës e për Bashkëpunim Ushtarak të Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë (ODC) dhe zëvendës drejtori i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s. Me këtë rast, sekretari në emër të Ministri Haki Demolli ka falënderuar ligjëruesit për punën profesionale gjatë mbajtjes së seminarit, njëherësh kërkoi nga seminaristët që të angazhohen, në të ardhmen që të gjitha njohurit profesionale, t'i bartin te vartësit e tyre duke i realizuar në aktivitete praktike.



Garda Kombëtare e Ajovës mbështet FSK-në

Ekipe të shtabit të Gardës Kombëtare të Ajovës në mbështetje të shtabit të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së po zhvillojnë punëtorinë me temë ,,Udhëheqësit Shtabor".Fokus i tyre është mbështetja e të gjitha departamenteve të KFT-së, në zhvillimin, avancimin dhe përafrimin e standardeve me Gardën Kombëtare të Ajovës, bazuar edhe në partneritetin FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës dhe të dy komandantëve; komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandantit të Gardës së Ajovës, gjeneral major Timothy Orr. Ekipi i Gardës Kombëtare të Ajovës i udhëhequr nga shefi i shtabit kolonel Michael Schlorholtz dhe stafi i tij u pritën nga zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, stafi i KFT-së dhe nga përfaqësues të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Po ashtu, një ekip nga Garda Kombëtare e Ajovës i udhëhequr nga kolonel Damian Donahoe



nga dt.11.09.2017 është duke e mbështetur personelin e KFT-së në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore (menaxhimi i ciklit jetësor), i cili po zhvillon diskutime me stafin nëpër të gjitha njësitë lidhur me sfidat dhe sukseset e arritura. Gjeneral Hazrolli, duke ju dëshiruar mirëseardhje ekipeve të Gardës së Ajovës, falënderoi gjeneralin Timothy Orr për krijimin e mundësive për bashkëpunim dhe ndarje të përvojave me shtabin e KFT-së. Ai njëherësh, para tyre, shprehu dhimbjen dhe përkrahjen e tij dhe të gjithë pjesëtarëve të FSK-së për katastrofën që ndodhi këto ditë në SHBA nga uragani "Irma". Partneriteti i krijuar në mes Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës ka përafruar vendet tona, dhe tashmë Kosova dhe Amerika nuk janë larg me njëra tjetrën, duke bashkëpunuar në të gjitha fushat me interes të përbashkët, u shpreh Hazrolli. Ndërkaq, koloneli Michael Schlorholtz u shpreh se ndjehet mjaft i emocionuar për vizitën. Ai veç tjerash tha: "Është hera e parë që jam këtu në Kosovë fizikisht, por jam i njoftuar shumë me aktivitetet dhe partneritetin. Shpreh kënaqësinë time për bashkëpunimin dhe ndarjen e përvojave me ju, pasi që edhe ne kemi sfida sikurse edhe ju". Më pas, kolonel Jeton Dreshaj, përmes një informimi të shkurtër i njoftoi të pranishmit me objektivat e komandantit të FSK-së, si dhe me fushat të cilat janë me interes të trajtohen gjatë kësaj punëtorie, si: Operacionet dhe trajnimet, parapërgatitja për dislokime, koordinimi me agjencitë e ndryshme në rasë krizash, zhvillimi i karrierës, inteligjenca, mirëmbajtja, sistemet e komunikimit, EOD, kërkim-shpëtimi (K9) MKAB etj. Punëtoria do të vazhdojë punimet deri më 15.09.2017, ku do të ketë vizita në njësit e FSK-së për të parë nga afër punën, pajisjet dhe procedurat standarde operative që zbatohen në FSK.



Përfundon punëtoria e përbashkët e Gardës Kombëtare të IOWA-s dhe Komandës së Forcave Tokësore

Në përmbyllje të punëtorisë së organizuar nga shtabi i Gardës Kombëtare të IOWA-s dhe shtabi i Komandës së Forcave Tokësore, si dhe në prezencën e komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, është prezantuar puna e grupeve në fushën e personelit, logjistikës, operativës dhe planifikimit. Kjo punëtori është realizuar nga oficerët e shtabit të Komandës së Forcave Tokësore në bashkëpunim me homologët nga Garda Kombëtare e Shtetit Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me fokus shtabin e KFT-së dhe njësitë e FSK-së, duke parë të arriturat dhe sfidat nëpër të cilat është duke kaluar Forca e Sigurisë së Kosovës. Shefi i shtabit të Gardës Kombëtare të IOWA-s, koloneli Schlorholtz MICHEAL u shpreh mjaft i kënaqur me partneritetin në mes të Gardës Kombëtare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, "ku gjatë këtyre ditëve të dy stafet kanë punuar mjaftueshëm dhe kanë gjetur fusha bashkëpunimi për tani dhe në të ardhmen".Koloneli Schlorholtz përveç bashkëpunimit çmoi lartë edhe mikpritjen që i është bërë nga i gjithë stafi i FSK-së dhe u shpreh i bindur që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tej. Në përmbyllje të kësaj punëtorie, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, falënderoi në veçanti komandantin e Gardës Kombëtare, gjeneral majorin Thimothy ORR, për mundësinë që shtabi i Gardës të IOWA-s të



jetë këtu së bashku me ne, për të diskutuar lidhur me të arriturat dhe sfidat me të cilat përballët Forca e Sigurisë së Kosovës. "Forca e Sigurisë së Kosovës ka edhe sfidat e saj politike të organizimit dhe planifikimit, mirëpo partneriteti që kemi dhe qëllimi ynë kanë ndihmuar në rritjen e progresit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe këtë partneritet do ta ngremë sa më lartë. Rekomandimet të cilat kanë dal nga kjo punëtori është me rëndësi që të futen në planifikim dhe të kenë një afat kohor për implementim, dhe kjo të bëhet në bashkëpunim të plotë në mes të departamenteve të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të IOWA-s".Gjeneral Rama dhe shefi i Shtabit të IOWA-s u zotuan për bashkëpunim edhe në të ardhmen, duke u shprehur se ky bashkëpunim do jetë shembulli më i mirë i të gjitha partneriteteve që ka IOWA me shtetet e ndryshme. Gjatë prezantimit përmbyllës ishin të pranishëm edhe drejtori i Drejtorisë së Operacioneve të Ministrisë së FSK-së, gjeneral brigade Zymer Halimi, zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri dhe oficerë të shtabit të Gardës Kombëtare të IOWA-s dhe FSK-së.

FORCA JONË

□□□ Viti VI □ Nr. 62 □Nëntor 2017 □Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës □□□

Kryeministri Ramush Haradinaj viziton ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kryeministri i Republikës së Kosovës, zotëri Ramush Haradinaj, më 12.10.2017 u prit me ceremoni ushtarake nga ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha. Pas intonimit të himnit të Kosovës, kryeministri Haradinaj dhe ministri Berisha parakaluan para Njësisë Ceremoniale të FSK-së. Fillimisht, ministri Berisha dhe kryeministri Haradinaj zhvilluan një takim kokë më kokë dhe pastaj vazhduan takimin e përbashkët, në të cilën ishin të pranishëm; zëvendësministrat e FSK-së, Brahim Mehmetaj dhe Agim Çeku, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralët e FSK-së, atasheu i Mbrojtjes së SHBA-ve, drejtori i Ekipit Këshillues dhe ndërlidhës të NATO-s për FSK, si dhe stafi i lartë i Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Fillimisht, ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha pasi falënderoi kryeministrin Haradinaj, për vizitën, e njoftoi atë me të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Ndërsa, nënkoloneli Haki Hoti, ushtrues detyre i shefit të Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim, para kryeministrit dhe stafit të lartë të MFSK-së, prezantoi të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Me këtë rast, Kryeministri i Kosovës z. Haradinaj, falënderoi ministrin Berisha për pritjen dhe njëherësh e përgëzoi për të arriturat e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pas takimit të përbashkët, në paraqitjen para mediave, Kryeministri i Kosovës tha: "Kam ardhur në institucionin ku suksesi më i madh është besimi i qytetarëve të vendit në FSK-në dhe ky besim duhet të lakmohet nga të gjitha institucionet e vendit. Por, kjo shkallë e lartë e besimit ka një sekret, pse ekziston ky besim, është një besnikëri në shërbim të të gjithë pjesëtarëve të Forcës, besnikëri në misionin që ata kanë me i shërbye atdheut dhe qytetarëve dhe po ashtu është një besnikëri ndaj aleatëve të Kosovës në temën e sigurisë, aleatëve që mund t'iu them dhe konfirmoj se ma shumë se kurrë janë sot në Kosovë dhe në FSK me perspektiven e Kosovës për, për t'i dhënë mandatin Kushtetues Ushtrisë së Kosovës. Përcaktimi i ynë



drejt NATO-s është përcaktim legjitim dhe u dedikohet të gjithë qytetarëve si dhe është në përputhje të plotë me të gjitha komunitetet dhe qytetarët e Kosovës dhe serbëve të Kosovës po ashtu. Jam i bindur që FSK-ja do ta vazhdojë këtë perspektivë të rritjes së besimit edhe të serbëve të Kosovës. Ndërsa, ministri i MFSK-së, z. Berisha, tha : "Me kënaqësi e pritem në vizitë pune kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotëri Ramush Haradinaj. Ne, zotëri Haradinajn e njoftuam për së afërmi me të arriturat e FSK-së, aktivitetet dhe proceset të cilat i kemi kaluar deri tani si dhe procesin e transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura, gjithashtu e njoftuam se ku kemi qenë, ku jemi dhe cilat janë sfidat që na presin në të ardhmen. Me këtë rast falënderoj kryeministrin Haradinaj edhe për vendimet e marra politike në emërimin e dy zëvendësministrave politikë të cilët që nga sot punojnë në MFSK. Në fund ministri i FSK-së, z. Berisha tha se nga kryeministri morëm shumë obligime dhe detyra duke e ditur se bashkërisht me stafin e FSK-së do t'i realizojmë të gjitha këto".

Komandanti i FSK-së pritet në Departamentin e Mbrojtjes dhe në Kongresin e SHBA-ve

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, i shoqëruar nga komandanti i Gardës Kombëtare të shtetit të Ajovës (Iowa), gjeneral major Timothy Orr, nga data 04-12 tetor 2017, po qëndron për vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA). Gjatë vizitës, gjenerallejtënant Rrahman Rama i shoqëruar nga një delegacion i FSK-së ka zhvilluar takime të nivelit të lartë në Departamentin e Mbrojtjes, në Departamentin e Shtetit dhe në Kongresin amerikan. Gjeneral Rama fillimisht është takuar me kongresmenet Paul Cook dhe Steve King si dhe me zëvendëskomandantin e Byrosë së Gardës Kombëtare të SHBA-ve, gjenerallejtënant Dan Hokanson. Më pas gjeneral Rama është takuar edhe me ndihmës sekretaren e Mbrojtjes për Rusi, Ukrainë dhe Euro-Azi, Laura Cooper. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i shoqëruar edhe nga ambasadorja e Kosovës në SHBA, ka mbajtur një takim edhe me z. Matt Palmer, drejtor i Zyrës për



Çështje të Evropës Jug-Qendrore në Departamentin e Shtetit. Komandanti i FSK-së, në të gjitha takimet e tij ka ritheksuar partneritetin dhe mbështetjen që SHBA po i jep FSK-së në zhvillimin dhe profesionalizimin e saj në të gjitha fushat. Ai po ashtu ka informuar nivelin e lartë të Mbrojtjes të SHBA-ve lidhur me procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura(FAK). Me rastin e vizitës së gjeneral Ramës, ambasadorja e Kosovës në SHBA zonja Vlora Citaku, në mjediset e Ambasadës së Republikës së Kosovës, ka organizuar koktej mirëseardhjeje për delegacionin, ku ishin të ftuar edhe atashetë e vendeve fqinje të Kosovës të akreditуar në SHBA. Me këtë rast, komandanti i FSK-së gjeneral Rama dhe atasheu i FSK-së në SHBA kolonel Ilir Qeriqi, i falënderuan mysafirët për mbështetjen dhe raportet e mira në kuadër të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve. Në kuadër të kësaj vizite KOMFSK ka takuar edhe pjesëtarët e FSK-së dhe të Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët ishin pjesëmarrës në vrapimin vjetor tradicional të Ushtrisë Amerikane "10 miler". Gjatë vizitës në SHBA, komandantin e FSK-së po e shoqërojnë atasheu i FSK-së në SHBA kolonel Ilir Qeriqi, atasheu i SHBA-së në Kosovë kolonel Jeffry Fischer, shef i Kabinetit të Komandantit të FSK-së kolonel Jeton Dreshaj si dhe asistenti ushtarak i komandantit kapiten Jaser Mulla. Gjate ditëve të ardhshme gjeneral Rama do të ketë aktivitete në kuadër të AUSA-s, një mundësi e mirë kjo për të parë dhe konceptuar sfidat e së ardhmes në teknologji dhe pajisje të sofistikuara ushtarake. Po ashtu do të ketë mundësi të takoi shumë shefa të shtabeve të ushtrive të rajonit dhe të botës. Qëllim i vizitës është thellimit dhe zgjerimit i bashkëpunimit në mes të Ushtrisë Amerikane dhe FSK-së.

Ministri Rrustem Berisha priti në takim ish-zëdhënësin e NATO-s, zotëri Jamie Shea

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha priti në takim (25.10.2017) ish-zëdhënësin e NATO-s gjatë periudhës së luftës në Kosovë, aktualisht zëvendës ndihmës sekretar i Përgjithshëm për sfidat në ardhje të sigurisë në NATO, z.Jamie Shea. Gjatë takimit, ministri Berisha pasi i shprehu mirëseardhje zotëri Shea-s për vizitën si dhe mirënjohjen për gjithë kontributin e tij gjatë shërbimit në detyrën e zëdhënësit të NATO-s, duke e cilësuar atë si një prej ushtarakëve i cili përforconte shpresën e popullit të Kosovës, në një periudhë mjaft të rëndë dhe duke shtuar se Jamea Shea është emër i njohur për secilin qytetar të vendit tonë. Gjithashtu, ministri Berisha e njoftoi zotëri Shea-n për zhvillimin, profesionalizmin dhe sukseset e Forcës së Sigurisë së Kosovës, arritjet në përfshirjen e grave dhe vajzave si dhe pjesëtarëve nga radhët e të gjitha komuniteteve në FSK, duke përplotësuar kapacitetet si dhe duke realizuar me sukses standardet bashkëkohore, standardet e NATO-s për të qenë forcë për të mirën e të gjithë qytetarëve të vendit si dhe kontribuuese për paqen në rajon e më gjerë, e gatshme për të qenë ndërvepruese, me të gjitha kapacitetet e saj, me ushtritë e vendeve të rajonit e më gjerë. Ministri i FSK-së u fokusua sidomos tek planet për avancimin e misionit të FSK-së, që ka dalë si nevojë nga procesi i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, si dhe duke vlerësuar përgatitjet dhe gatishmërinë operacionale të FSK-së, ai tha se është kohë e duhur që me angazhimet e faktorëve institucionalë dhe politikë të vendit të përmbyllim, të gjithë bashkërisht, këtë proces me vendim politik, në konsensus të plotë, të koordinuar brenda vendit, në transparencë të plotë me partnerët strategjikë dhe me NATO-n. Nga ana e tij ish-zëdhënësi i NATO-s, zotëri Jamea Shea tha se



ndjehet i impresionuar me progresin e arritur në zhvillimin e FSK-së dhe vlerësoi se të gjitha angazhimet e mëhershme, kontributi dhe sakrifica për paqe dhe siguri në Kosovë, kanë bërë që Kosova të prosperojë e pavarur në rrugën e saj. Zotëri Jamea Shea në fund e përgëzoi ministrin për detyrën duke u shprehur: ,,Njeriu i duhur, në kohën e duhur dhe në vendin e duhur".

Ministri Berisha priti në vizitë lamtumirëse gjeneralin Dietman Mosmman



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës zotëri Rrustem Berisha (10.10.2017) priti në takim lamtumirës drejtorin e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në, gjeneral brigade Dietmar Mosmman. Ministri Berisha me këtë rast e falënderoi gjeneralin Mosmman për angazhimin e tij gjatë shërbimin në NALT, gatishmërinë dhe përkushtimin e treguar gjatë bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me ministrin, personelin e ministrisë, Komandën e Forcës Tokësore dhe njësitë e saj. Ministri i FSK-së gjithashtu shprehu gatishmërinë për bashkëpunim edhe me pasardhësin në detyrë të gjeneralit Mosmman, oficerin gjerman, gjeneral brigade Hoffman, i cili është emëruar në detyrën e drejtorit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK. Nga ana e tij, gjenerali Dietmar Mosmman u shpreh se gjatë shërbimit të tij në detyrën e drejtorit të NALT-it ka pasur angazhim dhe koordinim të shkëlqyeshëm me FSK-në. Ai po ashtu vlerësoi lart përgatitjen profesionale të personelit ushtarak të FSK-së, duke filluar nga ushtarët, oficerët dhe nënoficerët, si dhe të stafit civil të MFSK-së.

Komandanti i FSK-së gjeneral Rama mori pjesë në Asociacionin e Ushtrisë së SHBA-ve

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama i shoqëruar nga një delegacion i FSK-së dhe ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA), zonja Vlora Çitaku,(12.10.2017) ishin pjesë në ceremoninë e hapjes së takimit vjetor të Asociacionit të Ushtrisë së SHBA-ve (AUSA). Gjeneral Rama së bashku me delegacionin e tij pritet të vazhdojë vizitën me takime të tjera të planifikuara në Pentagon. Në ceremoninë e hapjes së takimit vjetor të Asociacionit të Ushtrisë së SHBA-ve ishte i pranishëm Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, Jim Mattis si dhe shumë delegacione ushtarake nga mbi 70 shtete. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Mattis, gjatë fjalës së tij, kryesisht, theksoi sfidat e sigurisë globale. Komandanti i FSK-së, me këtë rast, ka zhvilluar edhe një varg takimesh të rëndësishme si: me shefin e Shtabit të Ushtrisë Amerikane, gjeneral Mark A. Milley dhe me shumë shefa të shtabeve të ushtrive të cilët ishin pjese në AUSA. Në Uashington, gjeneral Rama është takuar edhe me komandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges, me c 'rast kanë diskutuar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjithashtu ka takuar edhe drejtorin për Strategji, Politika dhe Plane në Departamentin e Operacioneve(G3/5), gjeneral major William Hix me të cilin ka diskutuar lidhur me procesët në të cilat po kalon FSK-ja dhe mundësitë e zhvillimit dhe perspektivës së saj në të ardhmen. Në të gjitha organizimet, komandanti i FSK-së i ka njoftuar partnerët më të arriturat e FSK-së, besueshmërinë, profesionalizmin dhe procesin e planifikuar për transformimit e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK).




Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama në emër të Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, (13.10.2017) ka dekoruar shefin e Shtabit të Forcave Ajrore të SHBA-ve, gjeneralin DavidGoldfein me dekoratën "Urdhri i Lirisë". Gjeneral Rama me këtë rast, në emër të popullit të Kosovës dhe pjesëtarëve të FSK-së, ka falënderuar gjeneralin Goldfein për sakrificën e tij në mbrojtje të vlerave demokratike dhe humane gjatë luftës së fundit në Kosovë, duke shtuar se populli i Kosovës do t'i jetë mirënjohës përgjithmonë popullit dhe Ushtrisë Amerikane. Komandanti i FSK-së dhe gjenerali Goldfein biseduan për nevojën e bashkëpunimit në të ardhmen, krijimin e mundësive për pjesëmarrje të kadetëve të FSK-së në Akademinë e Forcave Ajrore Amerikane, trajnime kibernetike si dhe për fusha tjera me rëndësi për FSK- në. Gjeneralit David Goldfein, shef i Shtabit të Forcave Ajrore pati marrë pjesë në bombardimet e NATO-s gjatë luftës në Kosovë dhe i pati mbijetuar rrëzimit të aeroplanit luftarak i cili ishte goditur nga Ushtria e ish-Jugosllavisë(Federata Serbi-Mali i Zi) gjatë fushatës së NATO-s në vitin 1999. Në takimin e komandantit të FSK-së me shefin e Shtabit të Forcave Ajrore të SHBA-ve ishin edhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral Timothy Orr, atasheu amerikan i Mbrojtjes në Kosovë, koloneli Jeffry Fischer dhe atasheu i Kosovës në Uashington, kolonel Ilir Qeriqi.

Komandanti i FSK-së, në emër të Presidentit të Kosovës, dekoron shefin e Shtabit të Forcave Ajrore të SHBA-ve

Gjenerali Gëzim Hazrolli ligjëroi në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Tiranë

Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës Tokësore(KFT) të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, më 18 tetor 2017 ka mbajtur një ligjëratë në Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me temën: ,,Mjedisi i sigurisë në rastin e Kosovës", si i ftuar në kuadër të bashkëpunimit me Republikën e Shqipërisë dhe shkëmbimit të përvojave mes institucioneve të sigurisë së dy shteteve. Gjeneral Hazrolli ka ligjëruar para oficerëve në Kursin për Oficerë të Lartë që është duke u realizuar në Akademinë Ushtarakë të Republikës së Shqipërisë, me ç 'rast pjesëmarrës ishin oficerë nga: Britania e Madhe, Turqia, Italia, Greqia, Maqedonia, Gjeorgjia, Rumania dhe Kosova. Në fokus të ligjëratës ishin aspektet e sigurisë në Republikën e Kosovës. Ligjërata e Hazrollit zgjoi interes te pjesëmarrësit.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Berisha raportoi në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje të FSK-së



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha, më 24.10.2017 mori pjesë për herë të parë që nga marrja e detyrës së ministrit, në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së (KPPBSMFSK) të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mbledhja e Komisionit Parlamentar u kryesua nga kryetari i Komisionit, deputeti Haxhi Shala. Në mbledhje morën pjesë deputetë të Parlamentit të Kosovës, anëtarë të këtij Komisioni, nga të gjitha grupet parlamentare. Ministri Berisha i njoftoi deputetët mbi gjendjen e trashëguar në Ministrinë për FSK dhe në FSK, gjendjen aktuale, objektivat strategjikë të tij për zhvillimin e Forcës, bashkëpunimin me partnerët strategjikë dhe shtetet e rajonit, bashkëpunimin me NATO-n, KFOR-in, përfshirjen dhe integrimin e komuniteteve në FSK si dhe mbi procesin e planifikuar të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës(FAK). I pari i MFSK-së, ministri Berisha tha: ,,Unë si ministër jam i interesuar në vendosjen e objektivave strategjike të cilat do të kenë për fokus: mirëmbajtjen e kapaciteteve të FSK-së, avancimin dhe zhvillimin më tutje të saj në të ardhmen, si forcë profesionale, multietnike, e cila do të jetë në të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës". Ne si Ministri e FSK-së dhe si FSK,- tha ministri, i kemi përcaktuar prioritetet tona. Prioriteti kryesor në të cilin do të fokusohemi është zhvillimi profesional i burimeve njerëzore brenda FSK-së, thellimi i bashkëpunimit me shtetet e rajonit, integrimi i komuniteteve jo-shumicë, në veçanti i komunitetit serb, që të jenë pjesë e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, sepse është interes i yni dhe i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Më tej, ministri Berisha informoi deputetët edhe për planet për transformimin e FSK-së në FAK, hapat që do të ndërmerren në këtë drejtim, transparencën e plotë të procesit, koordinimin e gjithanshëm institucional e politik si dhe koordinimin me aleatët strategjikë. Ministri i FSK-së u përgjigj edhe në pyetjet e deputetëve, anëtarë të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, të cilat kryesisht ishin me karakter informues rreth numrit të pjesëtarëve, armatimit, sektorit të shëndetësisë, hartimit të planeve për transformim, përfshirjes së komuniteteve, gradimit të pjesëtarëve etj.

FSK-ja institucioni i parë me Plan për Integritet



Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë prezantoi sot (26.10.2017) raportin e tretë monitorues dhe vlerësues me temën: Monitorimi dhe vlerësimi i integritetit në institucionet e sigurisë, që në fokus ishin dy institucionet më të besueshme të Kosovës: Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Në këtë prezantim morën pjesë: Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Shkëlzen Sylaj, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtor i Departamentit të Operativës dhe Trajnimeve, sekretari i sekretarit të përgjithshëm të MFSK-së, z. Florin Hoxha, përfaqësues të Policisë së Kosovës, të OJQ-ve si dhe monitorues dhe përfaqësues të mediave. Me këtë rast u tha se Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka për qëllim vlerësimin dhe monitorimin e aktiviteteve që lidhen me zhvillimet në fushën e integritetit në institucionin e FSK-së dhe MFSK-së dhe Policinë e Kosovës. Ky raport mbulon periudhën monitoruese tetor 2016-tetor 2017 dhe është vazhdimësi e raporteve tjera të QKSS-së, në funksion të ngritjes së integritetit në sektorin e sigurisë. Në prezantimin e raportit nga znj. Arife Muji për FSK-në u tha se Forca e Sigurisë së Kosovës aktualisht është një ndër institucionet e vetme të sigurisë në rajon që posedon Plan të Integritetit. Është pioniere në hartimin e Planit të Integritetit në nivel qendror, sepse deri në shtator të vitit 2017 Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës vazhdon të jetë institucioni i vetëm që ka arritur të hartojë dhe zbatojë një plan të tillë. MFSK-ja vazhdon zbatimin e këtij plani i cili në vetvete ngërthen masa dhe veprime në funksion të fuqizimit të integritetit. Raporti i prezantuar fokusohet kryesisht në pesë fusha kyçe: prokurimi publik, menaxhimi i burimeve njerëzore, auditimi i brendshëm, parandalimi i konfliktit të interesit si dhe deklarimi i pasurisë. Përmes vlerësimit të këtyre fushave, ky raport bën vlerësimin dhe identifikimin e sfidave dhe progresit të këtij institucioni, si dhe sjell rekomandime specifike në këto fusha. Besueshmëria, qeverisja e brendshme dhe integriteti janë parimet kryesore të cilat garantojnë funksionalizim të qëndrueshëm dhe kredibil të institucioneve të sigurisë në Kosovë. Ndërsa sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, në emër të Ministrit dhe Ministrisë për FSK-në, përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe njëherësh përgëzoi Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë për raportin hulumtues dhe tejet profesional. MFSK-ja dhe FSK-ja që nga 1 korriku i vitit 2016 kanë filluar implementimin e Planit të Integritetit falë ndihmës së Qeverisë së Norvegjisë. FSK-ja është njëri ndër përfituesit e vetëm të këtij projekti në rajon. Sekretari Sylaj, me këtë rast i njoftoi të pranishmit edhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me NATO-n. "FSK-ja ka përkrahje dhe bashkëpunim në këtë drejtim me Qeverinë e Norvegjisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë. Një bashkëpunim të shkëlqyeshëm kemi edhe me NATO-n, përmes Ekipit Ndërlidhës Këshillues (NALT) për FSK-në. Qëllimi ynë është që të jemi sa më bashkëpunues dhe transparent gjatë implementimit të këtij projekti tejet të rëndësishëm për FSK-në"-tha në vazhdim zotëri Sylaj.

Pjesëtarë të FSK-së përfunduan me sukses trajnimin "Kërkim-Shpëtim" në Republikën e Kroacisë





Në kuadër të bashkëpunimit bilateral me Republikën e Kroacisë dhe Kosovës dhe në kuadër të saj edhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Kroacisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), një ekip prej 11 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga Regjimenti i Mbrojtjes Civile (Task Forca e Kërkim-Shpëtimit) kanë realizuar trajnimin e kërkim-shpëtimit në male në Republikën e Kroacisë. Ky trajnim është realizuar nga data 16-27.10.2017 në bashkëpunim me Forcat e Armatosura të Republikës së Kroacisë, gjegjësisht njësinë Speciale Kroate në Kërkim-Shpëtim në male, me temën: "Ripelim, (me litarë) Kërkim-Shpëtim dhe Evakuim me Helikopter".Trajnimi i nivelit të tillë për pjesëtarët e FSK-së, ka një rendësi të veçantë për shumë arsye; krijimin e bashkëpunimit dhe përvojave që ka ushtria Kroate në lëmin e Kërkim-Shpëtimit në të gjitha fushat: si kërkim-shpëtim në male, në dete dhe atë urban, etj. Pjesëtarët e FSK-së, thanë se përvojat e fituara nga ky trajnim, do t`i përdorin në rastet reale në Kosovë, ku kjo njësi ka pasur intervenime të shpeshta në gjithë Kosovën në kërkimin-shpëtimin e jetëve të qytetarëve tanë.

U mbajt Konferenca e 7-të 'FSK dhe Partnerët'



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), më 23 tetor 2017 i filloi punimet edicioni i 7-të i Konferencës ,,FSK dhe Partnerët",ku po marrin pjesë atashetë ushtarakë dhe ata të mbrojtjes, përfaqësues të ambasadave të shteteve me të cilat MFSK-ja ka bashkëpunim bilateral dhe multilateral. Punimet e konferencës i shpalli të hapura, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha i cili tha se Konferenca e 7-të ,,FSK dhe Partnerët" përkon me fillimin e mandatit të tij si ministër, dhe se qëllimi i tij është intensifikimi i bashkëpunimit të ndërsjellë bilateral të FSK-së dhe shteteve partnere si dhe harmonizimi i aktiviteteve që kanë për qëllim mbajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të FSK-së. Gjithashtu, ministri Berisha foli për qëllimin e konferencës, harmonizimin e aktiviteteve si dhe koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta në përputhje me konceptet euroatlantike si dhe për kërkesat dhe nevojat për rritjen e nderveprueshmerisë. Ministri Berisha po ashtu i njoftoi ushtarakët dhe diplomatët e vendeve partnere mbi planifikimin për të ardhmen e FSK-së, ku ndër të tjera tha: "Ne jemi duke punuar në përgatitjen dhe planifikimin e ndryshimit të misionit tonë, respektivisht në ngritjen e kapaciteteve tona për misionin e ri kushtetues. "Ndërsa gjenerali i FSK-së Krahman Rama tha se roli i partnerëve ka ndikim të madh në avancimin e kapaciteteve të FSK-së. "Ne jemi institucioni më i besueshëm në pesë vitet e fundit. Ky është një privilegj, por në të njëjtën kohë dhe përgjegjësi t'i mbajmë standardet tona në nivelin më të lartë. Në konferencën e parë të FSK-së me partnerët, që është mbajtur në muajin prill, qëllimi ishte t'i prezantojmë tek ju nevojat tona për zhvillim të mëtutjeshëm të kapaciteteve të FSK-së dhe po ashtu t'i sinkronizojmë të gjitha aktivitetet me ju, në mënyrë që të kemi një qasje më të mirë në objektivat e përbashkëta, në procesin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur. Pasi që kjo është një çështje politike, ne si FSK jemi duke punuar ngushtë me partnerët tanë, për të vendosur kushtet e transformimit kudo që merret vendimi politik". Gjithashtu me nga një fjalë rasti, në punimet e konferencës u prezantuan edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral Giovani Fungo dhe drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s për FSK-në(NALT), gjeneral brigade Ralf Hoffman. Gjeneral Fungo, shprehu vlerësimin e tij për profesionalizmin e FSK-së. "Gjatë mandatit tim në KFOR kemi pasur trajnime dhe ushtrime për të rritur kapacitetet dhe ndërveprueshmërinë. Jemi të befasuar me profesionalizimin e FSK-së në ushtrimin 'Shpata e Argjendtë'. Po ashtu ushtarët e FSK-së, kanë marrë pjesë në ushtrime me shumë kapacitete, se si duhet të veprojnë në situata emergjente. Po ashtu zhvillimi i kapaciteteve të FSK-së, për sa i përket deminimit është bërë me shumë profesionalizëm. Ne kemi një rrjet komunikimi me të gjithë pjesëtarët e FSK-së, të cilët janë të shpejtë dhe efektivë" Ndërsa, gjeneral Hoffman tha se ekipi i tij është pikë referimi për koordinimin e aktivitetet aktuale dhe atyre të ardhshme të bashkëpunimit praktik ndërmjet NATO-s dhe Kosovës. Ai përmendi se që nga Konferenca e prillit e këtij viti, janë shënuar një varg aktivitetesh dhe vizitash nga zyrtarë të lartë të NATO-s, dhe pjesëmarrje të pjesëtarëve të FSK-së në aktivitete jashtë Kosovës. Konferenca ,,FSK dhe Partnerët" e 7-ta me radhë u organizua nga Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Siguri i Ministrisë për FSK. Kryesimin kësaj konference e bëri ushtruesi i detyrës së drejtorit të këtij departamenti, nënkoloneli Ali Krasniqi, i cili njëherësh temën me titull: ,,Bashkëpunimi bilateral në fushën e Sigurisë". Gjithashtu edhe Ilir Dugolli, drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë në Ministrinë e Jashtme të Kosovës, prezantoi Strategjinë Kombëtare për Integrimin në iniciativa regjionale. Në sesionin e parë të Konferencës, planet e bashkëpunimit bilateral për vitin 2018 i paraqiten: Atasheu i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, kolonel Ahmet Leka, IgorGabriq nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kroacisë, atasheu i Mbrojtjes së Gjermanisë pranë Ambasadës së Gjermanisë në Sarajevë, nënkolonel MartinHerrmann, nga Mbretëria e Holandës, atasheu i Mbrojtjes i Mbretërisë së Holandës, nënkolonel Theo



→

Drejtori Faruk Geci mori pjesë në takimin e shefave për politika dhe plane SHBA-Karta e Adriatikut

Me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Enver Cikaqi komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, më datë 25.10.2017 qëndroi për një vizitë pune në Tiranë, ku u prit nga komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) gjeneral brigade Manushaqe Shehu. Të dy gjeneralët biseduan për bashkëpunimin e ndërsjellë në mes FSK-së dhe FARSH-së si dhe shprehën gatishmërinë që ky bashkëpunim i dyanshëm të vazhdojë edhe në të ardhmen. Gjenerali Enver Cikaqi në Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). para pjesëmarrësve të Kursit të Lartë për Siguri dhe Mbrojtje ligjëroi, temën " Institutionalizing a Cooperative Security".Kursi i Lartë për Siguri dhe Mbrojtje (KLSM) është kursi më i lartë për zhvillim profesional në ushtrinë shqiptare, dhe ka qëllim që të edukojë ushtarakët dhe zyrtarët civil të Shqipërisë, regjionit të Ballkanit, aleatët e NATO-s dhe partnerët për përgjegjësi ekzekutive në nivel strategjik. Edhe këtë vit, në KLSM, merrnin pjesë pjesëmarrës nga disa shtete, duke përfshirë: Kosovën, Anglinë, Gjeorgjinë, Turqinë, Maqedoninë, Rumaninë dhe Italinë. Gjatë ligjërimit, gjeneral Cikaqi në veçanti foli edhe për sigurinë kolektive, institucionalizimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe bashkëpunimin e Kosovës në fushën e Sigurisë. Krejt në fund u zhvillua një debat i mirëfilltë, ku u diskutua me theks të veçantë për bashkëpunimin në siguri të Forcës së Sigurisë së Kosovës me partnerët. Gjatë kësaj vizite gjeneral Cikaqi takoi edhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës të cilët janë duke ndjekur trajnimet në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë, ku u njoftua me procesin e trajnimeve, sfidat dhe rezultatet e tyre gjatë kësaj periudhe të studimeve.

Pjesëmarrësit e Konferencës "FSK dhe Partnerët" vizituan kazermën "New Born" në Gjilan

Në ditën e dytë të konferencës ,,FSK dhe Partnerët", pjesëmarrësit e saj, diplomatë ushtarakë të shteteve partnere të FSK-së, më 24 tetor 2017 vizituan kazermën ,,New Born" të Batalionit të Parë të Reagimit të Shpejtë të FSK-së në Gjilan. Ata u pritën nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zv. komandanti i Komandës së Forcës Tokësore, gjeneral Gëzim Hazrolli, drejtori i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjeneral Zymer Halimi, UD. i komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci dhe komandanti i Batalionit të Parë, major Berat Shala. Koloneli Xhevahir Geci i njoftoi ushtarakët e lartë ndërkombëtarë lidhur me misionin, detyrat dhe aktivitetet e brigadës që ai komandon. Ndërsa majori Berat Shala i njoftoi mysafirët në hollësi me misionin, detyrat dhe aktivitetet e Batalionit të Parë të Reagimit të Shpejtë. Në përmbyllje të kësaj konference, atashetë ushtarakë të shteteve mike të akredituar në Republikën e Kosovës dhe në shtetet e rajonit, patën mundësi të njihen nga afër edhe me disa nga aktivitetet kryesore të BRSH-së, të kësaj njësie elitë të FSK-së.



Plijner, atasheu i Mbrojtjes së Republikës së Turqisë, nënkolonel Rusen Abidinoglu, atasheu i Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Richar Parry. Në emër të Zyrës për Bashkëpunim të Ambasadës Amerikane, për bashkëpunimin bilateral ndërmjet SHBA-ve dhe FSK-së, prezantuan Arina Beka dhe Zana Tropoja, si dhe nga Republika e Maqedonisë, AvniSaliji. Në punimet e Konferencës së 7-të ,,FSK dhe Partnerët" përveç ministrit dhe komandantit ishin të pranishëm edhe zëvendësministri Agim Çeku, sekretari i përgjithshëm, Shkelzen Sylaj, drejtori i Inspektoratit të FSK-së, gjeneral brigade Bashkim Jashari, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Faruk Geci, drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës Tokësore(KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi, ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë(BRSH), kolonel Xhevahir Geci, ushtrues detyre i komandantit të brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO), kolonel Avdi Raci, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri si dhe atashetë e FSK-së; në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht në vendet e Beneluksit(Belgjikë, Holandë dhe Luksemburg), nënkolonel Enver Dugolli dhe nënkolonel Ahmet Ajeti. Për herë të parë, në Konferencës ,,FSK dhe Partnerët", po marrin pjesë edhe oficerë nga Ministria e Mbrojtjes së Malit të Zi, krahas diplomatëve ushtarakë nga shtetet partnere si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Shqipëria, Maqedonia, Turqia, Japonia, Holanda, Gjermania, Italia, Kroacia, Belgjika etj. Konferenca vazhdon punimet edhe nesër. Në ditën e saj të dytë do të vizitohet Batalioni i Parë i Reagimit të Shpejtë në Gjilan.

Takime të shumta të ministrit Rrustem Berisha me ambasadorë të vendeve mike



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, gjatë këtij muaji, priti në takime të ndara ambasadorët e vendeve mike si:ambasadorin e Norvegjisë z. Stand Sjaastad, të Republikës së Shqipërisë z. Qemal Minxhozi, të Sllovenisë z. Bojan Bertoncelj, të Hungarisë z. Laszlo Markusz dhe ambasadorin e Gjermanisë z. Christian Heldt. Gjatë takimeve të tij me ambasadorët e akredituar në Prishtinë, ministri Berisha i ka falënderuar ata dhe përmes tyre shtetet që ata përfaqësojnë, për bashkëpunimin dhe për ndihmat e vazhdueshme të vendeve të tyre dhënë ndër vite Kosovës, Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë. Ministri Berisha gjithashtu i ka njoftuar ambasadorët për të arriturat e FSK-së në të gjitha fushat, si dhe për planet dhe sfidat për transformimin e saj në Forca të



Armatosura, duke shtuar se procesi i transformimit do të jetë transparent, i koordinuar mirë me faktorin e brendshëm, NATO-n dhe partnerët strategjikë, si dhe duke nënvizuar se krijimi i FAK-ut do të



jetë në të mirë të shtetit të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve pa dallim etnie, race etj. Ministri Berisha po ashtu i ka falënderuar ambasadorët për projektet e shumta, që vendet e tyre janë duke realizuar, në kuadër të Ministrisë dhe FSK-së, në ngritjen profesionale dhe aftësimin e kuadrove; oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së në akademitë e tyre ushtarake. Ministri kërkoi nga ambasadorët rritjen e bashkëpunimit edhe në fushat tjera me interes të dyanshëm. Në veçanti kërkoi, nga ta, mbështetjen e shteteve të tyre për anëtarësimin e FSK-së në mekanizma tjerët të sigurisë,



duke shtuar se FSK-ja duhet të jetë kontribuues i paqes dhe sigurisë në rajon. Ambasadorët, nga ana e tyre, duke shprehur mirënjohje për pritjen, premtuan angazhimin dhe mbështetjen e shteteve të tyre në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së dhe njëherësh rritjen e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët, në të mirë të sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

Më 5 tetor, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK) z Shkëlzen Sylaj në emër të ministrisë dhe z. Adem Gashi, drejtor i Departamentit të Operimeve dhe Mirëmbajtjes, në emër të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës ANP) ,,Adem Jashari", nënshkruan sot marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve. Marrëveshja e bashkëpunimit në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës ,,Adem Jashari", ka për qëllim mbështetjen në planin emergjent të LIMAK-ANP-së nga MFSK/FSK-ja. Në tekstin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MFSK/FSK-së dhe Limak-ANP-së janë konkretizuar aspektet e këtij bashkëpunimi dhe janë caktuar njësitë e specializuara të cilat do të reagojnë në raste emergjente; njësitë e



Regjimentit të Mbrojtjes Civile dhe Kompania e Mjekësisë, të cilat FSK-ja do t'i angazhojë në rastet kur Limak-ANP-ja kërkon nga FSK-ja. Kjo është marrëvesh-

ja e parë e bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe se përgjegjës për zbatimin e saj janë të dy palët.

Behar Fazliu kadeti më i mirë ndërkombëtarë në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore në Mbretërinë e Bashkuar



Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, nëntogeri Behar Fazliu, pas një trajnimi gjashtë mujor në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore në Cranwell të Mbretërisë së Bashkuar u nderua me çmimin "Kadeti më i mirë ndërkombëtarë". Në ceremoninë e organizuar (6.10.2017)me rastin e diplomimit të oficerit të FSK-së mori pjesë ambasadori fuqiplotë i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, z. Lirim Greiçevci. Çmimi "Kadeti më i mirë ndërkombëtarë" për nëntoger Behar Fazliun, por edhe çmimet tjera të mëparshme janë dëshmi se FSK-ja është në rrugë të duhur sa i përket ngritjes profesionale të pjesëtarëve të saj, dhe se ky kualitet profesional është duke u dëshmuar edhe jashtë vendit si në; shkollime, trajnime, operacione, por edhe në akademitë më prestigjioze. Nëntogeri Behar Fazliu, pas kthimit nga Mbretëria e Bashkuar, do të vazhdojë shërbimin në Batalionin e Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) ku është i sistemuar për të dhënë kontributin e tij në zhvillimin dhe profesionalizimin e batalionit, por edhe të FSK-së në përgjithësi.

Gjenerali Enver Cikaqi ligjëroi në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë

Me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Enver Cikaqi komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, më datë 25.10.2017 qëndroi për një vizitë pune në Tiranë, ku u prit nga komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) gjeneral brigade Manushaqe Shehu. Të dy gjeneralët biseduan për bashkëpunimin e ndërsjellë në mes FSK-së dhe FARSH-së si dhe shprehën gatishmërinë që ky bashkëpunim i dyanshëm të vazhdojë edhe në të ardhmen. Gjenerali Enver Cikaqi në Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). para pjesëmarrësve të Kursit të Lartë për Siguri dhe Mbrojtje ligjëroi, temën " Institutionalizing a Cooperative Security".Kursi i Lartë për Siguri dhe Mbrojtje (KLSM) është kursi më i lartë për zhvillim profesional në ushtrinë shqiptare, dhe ka qëllim që të edukojë ushtarakët dhe zyrtarët civil të Shqipërisë, regjionit të Ballkanit, aleatët e NATO-s dhe partnerët për përgjegjësi ekzekutive në nivel strategjik. Edhe këtë



vit, në KLSM, merrnin pjesë pjesëmarrës nga disa shtete, duke përfshirë: Kosovën, Anglinë, Gjeorgjinë, Turqinë, Maqedoninë, Rumaninë dhe Italinë. Gjatë ligjërimit, gjeneral Cikaqi në veçanti foli edhe për sigurinë kolektive, institucionalizimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe bashkëpunimin e Kosovës në fushën e Sigurisë. Krejt në fund u zhvillua një debat i mirëfilltë, ku u diskutua me theks të veçantë për bashkëpunimin në siguri të Forcës së Sigurisë së Kosovës me partnerët. Gjatë kësaj vizite gjeneral Cikaqi takoi edhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës të cilët janë duke ndjekur trajnimet në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë, ku u njoftua me procesin e trajnimeve, sfidat dhe rezultatet e tyre gjatë kësaj periudhe të studimeve.

Mjekët e FSK-së realizojnë vizita mjekësore për komunitetet

Njësia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza (NJNRK) e Forcës së Sigurisë së Kosovës së bashku me Kompaninë e Mjekësisë, përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-ve-Zyra e Elementit Mbështetës Civilo-Ushtarak si dhe përfaqësuesit e drejtorive për mirëqenie sociale të komunave Ferizaj dhe Lipjan më 4 tetor 2017, kanë realizuar projektin humanitar në ndihmë të komuniteteve, duke kryer kështu vizita mjekësore tek personat e moshuar të komuniteti serb. Vizitat janë realizuar në Lipjan dhe në fshatrat Bablak dhe Pleshinë, nga mjekët e Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me mjekët e qendrave të Mjekësisë Familjare në Ferizaj dhe Lipjan dhe Zyra e Elementit Mbështetës Civilo-Ushtarak (ZEMCU-së). Vlen të ceket se ky projekti është pritur jashtëzakonisht mirë nga të moshuarit e komunitetit serb të cilëve iu është ofrua ndihma, gjë të cilën e dëshmon edhe znj. Gospogjinka Millovanoviq nga fshati Bablak, e cila u shpreh mjaft e kënaqur dhe falënderuese për kujdesin dhe ndihmën që i është dhënë. Projekti humanitar në ndihmë të komuniteteve që jetojnë në Kosovë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Pjesëtarë të FSK-së kanë kryer trajnimin "Menaxhimi në nivel ekipi dhe skuadre"

Në Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, sot përfundoi punëtoria një javore "Menaxhimi në nivel ekipi dhe skuadre" e që u realizua në Batalionin e Xhenios. Në këtë punëtori morën pjesë 35 pjesëtarë të FSK-së; të nivelit oficerë dhe nënoficerë, filloi realizimin me datën 23-27.10.2017, nga ekipi i ekspertëve amerikanë të Gradës Kombëtarë të Ajovës, me qëllim të krijimit të "Librit të Liderit". Në ceremoninë përmbyllëse ishte i pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, rreshter majori i Forcës së Sigurisë së Kosovës Genc Metaj dhe oficerë të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Para të pranishmëve për rëndësinë e kësaj punëtorie, rolin e nënoficerëve në ushtri dhe bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të IOWA-s, foli gjenerali Gëzim Hazrolli. Ai falënderoi gjeneralin Orr dhe ekipin e instruktorëve amerikanë. "falënderoj gjeneralin Orr dhe ekipin e instruktorëve për kohën që e kanë ndarë dhe për përkrahjen e vazhdueshme që janë duke bërë, që ne të arrijnë në



nivelin e duhur dhe njëherësh pres që një libër i tillë, të jetë model për oficerët dhe nënoficerët tanë, të cilët janë shtylla kryesore e Ushtrisë dhe dalëngadalë të ndërtohet një standard".Për rrjedhat e punëtorisë, rreshter majori Genc Metaj u shpreh mjaft i kënaqur për punën që është bërë gjatë kësaj javë, si dhe për produktin e krijuar. "kjo punëtori është realizuar në një frymë mjaft të mirë të bashkëpunimit, ku kemi arrite të krijojmë një produkt mjaft efikas i cili do t'iu shërbej nënoficerëve që ta kenë më të lehtë menaxhimin e pjesëtarëve në varësi të tyre".E kënaqur nga realizimi i kësaj punëtorie ishte edhe rreshter major Fails Rachel Fails e Gardës Kombëtare të IOWA-s, e cila përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për suksesin dhe interesin e treguar gjatë kësaj punëtorie, dhe ndër të tjera shtoi: "falë një bashkëpunimi mjaft të mirë për një periudhë kaq të shkurtër, kemi arrit që ta krijojmë këtë dokument në të cilin kemi përfshi pjesët më të rëndësishme, e i cili nuk do të përfundojë me kaq, po do të vazhdojë të plotësohet me materiale shtesë gjatë gjithë kohës".Kjo punëtori pritet të vazhdojë punimet serish në dhjetor të këtij viti, dhe u realizua në kuadër të bashkëpunimit bilateral me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ishte e ndarë në tri grupe: të Personelit, Trajnimeve dhe Logjistikes.

Rreshter majori i Komandës së Bashkuar për Operacione të NATO-s Davor Petek vizitoi FSK-në

Sot në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe në FSK qëndroi për një vizitë pune, rreshter majori i Komandës së Bashkuar të Operacioneve të NATO-s, Davor Petek (shoqërohej nga rreshter majorët e NATO-s dhe NALT-it), i cili u prit nga rreshter majori i FSK-së Genc Metaj dhe rreshter majorët tjerë të FSK-së. Rreshter majori Metaj fillimisht e njoftoi homologun e tij dhe delegacionin e NATO-s për strukturën, kapacitetet, projektet humanitare, trajnimet, shkollimet, zhvillimin e strukturës së Trupës së Nënoficerëve të FSK-së, bashkëpunimin ndërkombëtar të FSK-së, partneritetin me Gardën Kombëtare të Ajovës dhe bashkëpunimin me Ekipin Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NALT) për FSK-në. Në takim u bisedua edhe për mundësinë e shfrytëzimit të ndihmës që ofron NATO-ja në edukimin e ushtarakëve të FSK-së. Nga ana e tij rreshter majori Petek prezantoi Strategjinë e re të NATO-s dhe udhëzimet për zhvillimin e Trupës së



Nënoficerëve. Ai gjithashtu u shpreh i kënaqur që FSK-ja është duke zhvilluar me sukses Trupën e Nënoficerëve, në përputhje me këtë strategji, dhe premtoi se do të vazhdojnë t'i ndjekin shembujt më të mirë për avancimin e njohurive për ushtarët dhe nënoficerët e FSK-së. Delegacioni i NATO-s, i prirë nga rreshter majori Davor Petek, vizitoi edhe Batalionin e Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) në Istog, ku u njoftua për së afërmi me zhvillimet dhe trajnimet e njësive të FSK-së.

Certifikohen pjesëtarë të FSK-së për përdorim të Radio-pajisjeve taktike "Harris"



Në kompaninë e Komunikimit të FSK-së, dje (6.10.2017) u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të cilët përfunduan trajnimin për "Radio-pajisjet taktike Harris". Në ceremoni të pranishëm ishin: Shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel Naim Haziri, drejtori i Departamentit të Komunikimit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK) Beqir Bytyqi, shefi i Zyrës së Komunikimit në KFT, nënkolonel Gyrner Murati, si dhe oficerë të FSK-së. Me këtë rast, të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Naim Haziri, i cili pasi përgëzoi pjesëtarët për përfundim me sukses të këtij trajnimi, dhe njëherësh falënderoi instruktorët që e organizuan dhe realizuan trajnimin, shtoi: "Pajisjet e komunikimit janë njëra prej arterieve kryesore për funksionimin e mirëfilltë të një institucioni, dhe shpresoj që pas këtij trajnimi, pesë javor, ju keni arrit të aftësoheni që t'i përdorni në mënyrë sa më të drejtë këto pajisje mjaft të rëndësishme për FSK-në, kur dihet që komunikimi është qelës i suksesit për ne". Trajnimi ka filluar me 4 shtator dhe përfundoi më 5 tetor 2017, u realizua nga instruktorët e Kompanisë Harris, me qëllim të përdorimit në mënyrë sa më të drejtë të pajisjeve HARRIS, të cilat janë donacion nga Ambasada e SHBA-ve për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kadetët e FSK-së pritën në vizitë kadetët e Akademisë Ushtarake të Maqedonisë

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore në Prishtinë, qëndroi sot (14.10.2017) një delegacion i kadetëve të Akademisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë, i cili u prit nga kadetët e Qendrës për Studime Universitare (QSU) të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Delegacioni i AUFARM-së, në krye me profesorin e akademisë, kolonel Aleksander Glavinov, së bashku me ekipin e tij prof. kolonel Nikolov Elinjor, komandantin e Akademisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë (FARM) nënkolonel Dejan Jovanovski si dhe oficerë dhe nënoficerë të Republikës së Maqedonisë, u prit nga zëvendëskomandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjeve (KDS) kolonel Irfete Spahiu si dhe ushtruesi i detyrës së Komandantit të QSU-së, kapiten Vegim Krelani. Pas njoftimit dypalësh, kadetët u njoftuan edhe me hapësirat e brendshme të Kazermës si dhe realizuan gara sportive në disa disiplina si: futboll, volejboll, pingpong dhe shah. Pas garave, në Sallën e Sporteve të kësaj kazerme u mbajt edhe ceremonia e ndarjes së çmimeve. Vendi i parë në pingpong i takoi kadetit të QSU-së Edolind Vishaj. Në shah vendin e parë e zuri kadeti nga QSU-ja Adin Musiq. Në futboll takimi u mbyll me rezultat baras 4:4. Ndërsa në volejboll fitoi ekipi i kadetëve të QSU-së. Si kadetët e FSK-së ashtu edhe të ata të FARM-së u ndanë të kënaqur me realizimin e kësaj vizite dhe me garat në përgjithësi, pavarësisht nga rezultati i garave. Me këtë rast, para të pranishmëve foli kolonel i FSK-së, Irfete Spahiu e cila falënderoi kadetët e dyja qendrave universitare për spektaklin e dhuruar gjatë





kësaj dite duke shtuar: "Në gara të tilla sportive ndërmjet shteteve mike nuk ka humbës. Me organizimin e aktiviteteve të tilla të gjithë jemi fitues dhe kërkoj nga ju, si dëshmitar të një fryme të tillë të bashkëpunimit të avancuar, ta vazhdoni këtë formë të bashkëpunimit edhe në të ardhmen tuaj". Ndërsa nga ana e delegacionit të Maqedonisë, foli koloneli Aleksander Glavinov i cili u shpreh mjaft i kënaqur nga mirëpritja që ju bë sot, si dhe nga vizita në përgjithësi duke thënë: " Një bashkëpunim i tillë si ky i yni nuk do të përfundojë me këtë vizitë pasi që ne jemi duke planifikuar edhe organizime dhe bashkëpunime të ndryshme të cilat ndihmojnë në njohjen tonë të cilat janë të mirëseardhura për të dy armatat". Kjo vizitë u bë e mundur falë bashkëpunimit dypalësh që Forca e Sigurisë së Kosovës ka me Forcat e Armatosura të Republikës së Maqedonisë, dhe që ka për qëllim thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

FSK sfidon pjesëtarët me garën 'Shqiponja Patrulluese 17'

Me direktivë dhe urdhër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, është duke u zhvilluar ushtrimi fushor njëjavor "Shqiponja Patrulluese 17", i cili ka për qëllim sfidimin dhe kalitjen e pjesëtarëve për misionin që ka FSK-ja . Në terrenet e ushtrimit dhe të zhvillimit të aktivitetit garues, sot (3.10.2017) ishin për vizitë zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel



Xhevahir Geci, ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Mbështetje Operacionale, kolonel Avdi Rraci, shefi i Shtabit të BRSH-së, nënkolonel Ejup Maqedonci, këshilltari ushtarak britanik i komandantit të FSK -së, nënkolonel Gregor Lindsay, pastaj kolonel Bashkim Shillova, nënkolonel Ali Krasniqi, si dhe ushtarakë ndërkombëtarë të ekipit këshillues dhe ndërlidhës të NATO-s për MFSK-në dhe FSK-në (NALT) si dhe oficerë tjerë të FSK-së. Gjeneral Hazrolli, duke parë nga afër gatishmërinë e pjesëtarëve për t'u kalitur në përballje me sfidat e terrenit, i përgëzoi stafin planifikues të oficerëve si dhe pjesëtarët e skuadrave garuese të cilët me sukses dhe përkushtim demonstruan aktivitetet e parapara sipas skenarit. Gjeneral Hazrolli tha më tej se planifikimi i mirë, puna ekipore dhe motivimi i lartë kanë bërë që ky ushtrim garues të jetë kaq madhështor. Me këtë rast, gjeneral Hazrolli falënderoi edhe ushtarakët britanikë dhe kanadezë për mbështetjen e tyre në realizimin e këtij ushtrimi. Për të krijuar një tablo më të plotë të ushtrimit garues ,,Shqiponja Patrulluese 17" një informim të shkurtër paraqiti kapiteni Vegim Kelani. "Ushtrimi ka filluar më 29 shtator dhe do të përfundojë më 6 tetor 2017. Stërvitjet përgatitore janë zhvilluar në një periudhë gjashtëmujore në çdo njësi madhore të FSK-së, ndërsa për garën finale janë kualifikuar tetë (8) skuadra me nga 72 pjesëtarë, të cilët do të vazhdojnë aktivitetet e tyre ditën dhe natën derisa të përfundojë i gjithë skenari i ushtrimit, ku edhe do të shpallën fituesit e garës". Nga ana e tij, këshilltari britanik i komandantit të FSK-së, nënkolonel Gregor Lindsay, i cili ka qenë i angazhuar në vazhdimësi në mbarëvajtjen e këtij ushtrimi, tha se është i lumtur që gara e organizuar për herë të parë në FSK po zhvillohet me kaq sukses dhe përkushtim. Kjo garë e organizuar, këtë vit nga oficerët dhe nënoficerët e FSK-së, sipas modelit të Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar parashihet të jetë garë tradicionale vjetore, ku do të ftohen edhe ushtarakë nga ushtritë e shteteve tjera të rajonit.





Me ceremoni të posaçme shpallen fituesit e ushtrimit "Shqiponja Patrulluse-17"

Sot (6.10.2017) në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) të FSK-së, u mbajt ceremonia e shpalljes së fituesve të garës të FSK-së, në ushtrimin "Shqiponja Patrulluse-17" të mbajtur me urdhër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, "me qellim të sfidimit dhe kalitjes fizike për realizmin e misionit që ka FSK-ja". Fituesit e garës të ushtrimit "Shqiponjat Patrulluese-17" janë: Komanda e Forcave Tokësore me ushtrues skuadre, nëntoger Arsim Dreshaj, e cila zuri vendin e parë. Në vendin e dytë u rendit, Batalioni i Dytë i BRSH-së, me udhëheqës skuadre, nëntoger Gentrit Idrizi,



kurse vendin e tretë e zuri Batalioni i Tretë, me udhëheqës skuadre, nëntoger Drilon Hasani. Në ceremoninë e certifikimit merrnin pjesë: ministri i MFSK-së, zotëri Rrustem Berisha, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrrolli, përfaqësues të NALT-it, (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, për FSK-në), Mark Theobald, kolonel Xhevahir Geci, ushtrues i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë, ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Mbështetje Operacionale, kolonel Avdi Rraci, këshilltari ushtarak i komandantit të FSK-së, nënkolonel Gregor Lindsay, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Naim Haziri, shefi i Kabinetit të ministrit, z. Jashar Ramadani, komandantët e njësive të FSK-së, si dhe oficerë të tjerë të FSK-së. Me këtë rast, ministri i MFSK-së, z. Rrustem Berisha, pasi përgëzoi ushtarët dhe stafin udhëheqës të FSK-së, për realizimin e ushtrimit; Shqiponja patrulluese 17, pos tjerash tha: "Është me rëndësi që brenda FSK-së, duhet të vazhdojmë të kemi një frymë garuese, me qellim të ngritjes të sukseseve tona, drejtë realizimit të misionit që kemi". Ministri Berisha në fund i përgëzoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së. "Prandaj, ju përgëzoj për sukseset që keni arritur. Urojë që në të ardhmen në organizime të tilla garuese të marrin pjesë edhe shtete e rajonit. Jam informuar për sukseset e më hershme në garat e ngjashme që keni pasur në vitin 2015 në Angli. Është më shumë rëndësi që kurë marrim pjesë në angazhimet jashtë vendit, që t'i marrim modelet e suksesshme, që njohuritë e fituara jashtë vendit t'i bartim te personeli dhe stafi ynë". Po ashtu ministra Berisha ka vlerësuar lartë punën e instruktorëve nga Anglia dhe Kanadaja si në aspektet e planifikimit dhe organizimit të kësaj gare. Ndërsa zëvendëskomandanti i KFT-së, gjenerali Gëzim Hazrolli në fjalën e tij, tha: "Ndihem krenar me rezultatet e arritura gjatë kësaj gare. Organizimi i garës është bërë sipas modelit Britanik të "Cambrian Patrol", me qellim që të zhvillohet dhe të ndërtohet një traditë, ku do të marrin pjesë edhe partnerë tanë. Gjithashtu, gjeneral Gëzim Harolli, për këto arritje falënderoi instruktorët britanikë dhe ata të Kanadasë. "Falënderoj instruktorët nga Britania dhe Kanadaja si për planifikimin dhe organizimin e garës. Po ashtu dua të falënderoj të gjithë oficerët dhe pjesëtarët që kanë kontribuar në realizimin me sukses të kësaj gare. Po ndihem krenar me nivelin e moralit dhe angazhimit tuaj, në realizimin e detyrave. Urime dhe suksese tjera", e përmbylli fjalën e tij gjeneral Hazrolli. Kurse kapiteni Vegim Krelani, komandant i garës, tha: "Garuesit janë sfiduar të përballojnë të papriturat dhe të ndihmojnë shokun e skuadrës, me aftësinë për të përballur vetën si në situata fizike ashtu dhe psikike. Ju jeni sfiduar të merrni vendime në situata kurë keni qenë të lodhur dhe të uritur. Dhe ju me sukses i keni kaluar të gjitha sfidat". Stërvitjet përgatitore për ushtrimin garues "Shqiponja fluturuese 17" janë zhvilluar në çdo njësi madhore të FSK-së, për gjashtë muaj. Ndërsa për garën finale janë kualifikuar tetë skuadra me nga 72 pjesëtarë, të cilët kanë vazhduar aktivitetet ditën dhe natën, deri sa kanë përfunduar skenarin e ushtrimit, kur edhe u shpallën fituesit e garës. Zëvendëskomandanti KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ekipit trajnues nga Britania e Madhe dhe Kanadaja u dha Mirënjohje, për mbështetjen profesionale të FSK-së, në garën "Shqiponja Patrulluese 17". Ushtrimi "Shqiponja Patrulluese 17" për herë të parë u planifikua dhe u realizua nga pjesëtarët e FSK-së, dhe është modeli më i avancuar i ushtrimeve të këtij lloji. Kjo garë këtë vit organizohet për herë të parë nga oficerët dhe nënoficerët e FSK-së, sipas modelit të ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe parashihet të jetë garë tradicionale vjetore, ku do të ftohen edhe ushtarak të ushtrive të shteteve tjera të rajonit.

FORCA JONË

Viti VI • Nr. 63 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

FSK-ja në shërbim të gjithë qytetarëve!



Prishtinë, 27 Nëntor 2017

FORCA JONË

Viti V • Nr. 63 •Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti i V • Nr. 63 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun,
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma ,,Adem Jashari'', Prishtinë
Adresa elektronike: informimi.mfsk@gmail.com, informimi.mfsk@rks-gov.net
Tel: 038/551-379

www.mksf-ks.org





Përkushtim, punë dhe profesionalizëm i lartë në FSK

Forca e Sigurisë së Kosovës, gjatë këtij viti u angazhua me punë serioze, disiplinë, dhe me një planifikim të mirë të stafit komandues të FSK dhe njësive të saj, si dhe me një menaxhim dhe funksionim efikas të komandës dhe kontrollit, ka shënuar suksese në realizimin e misionit të saj, ka kryer me sukses të gjitha detyrat, duke qenë aktive dhe bashkëpunuese me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë, si dhe ndërvepruese me ushtritë e vendeve partnere në regjion dhe më gjerë.

Ne jemi fokusuar në vendosjen e politikave strategjike të cilat nënkuptojnë që FSK-ja të mbajë, të zhvillojë dhe të qëndrojë si forcë profesionale, multietnike, që ofron mundësi të barabarta.

Në vazhdim të ngritjes profesionale dhe barazisë gjinore FSK-ja ka shënuar rritje për 8 për qind të gjinisë femërore, ku grada më e lartë është grada kolonel, ndërsa 10 për qind, përbëhet. nga pjesëtarët e komunitetit jo shumicë.

Në këtë fund vit u graduan edhe pesë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nga komuniteti jo shumicë dhe ne jemi të përkushtuar për integrimin e qëndrueshëm të komuniteteve në FSK dhe në këtë drejtim kemi realizuar objektivat tona të parapara.

Duke marrë parasysh të arriturat e deritanishme, opinioni publik në të gjitha sondazhet e realizuara ka vlerësuar Ministrinë për FSK-në dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës si institucionin më të besueshëm në vend.

Në këtë kontekst duhet vlerësuar dhe falënderuar Ekipin Këshillëdhënës Ndërlidhës të NATO-s (NALT) për FSK-në, dhe partnerët tanë strategjik që kanë ndihmuar në zhvillimin e politikave, që kanë rezultuar fuqishëm në të gjithë sistemin e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, e sidomos bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Gardën Kombëtare të Ajovës dhe me partnerë tjerë strategjikë.

Po këtë vit kemi pasur bashkëpunim të mirë me vendet fqinje, kemi dhënë kontributin tonë në nismat regjionale të sigurisë, në të mirë të paqes dhe sigurisë jo vetëm në regjion por edhe më gjerë.

Forca e Sigurisë së Kosovës me aktivitetet e saja të shumta, angazhim dhe punë të përkushtuar, dhe me kapacitetet e plota operacionale, bazuar në mandatin aktual ka realizuar të gjitha detyrat e planifikuara.

Andaj jemi të gatshëm që me këto kapacitete ekzistuese të shndërrohemi nga konsumues të sigurisë në ofrues të sigurisë për qytetarët tanë, drejt synimit për transformimin nga FSK në Forca të Armatosura të Kosovës.

Rrustem Berisha Ministër për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Vit i zhvillimit profesional dhe integrimit të plotë të komuniteteve jo-shumicë



Forca e Sigurisë së Kosovës, që nga themelimi i saj në vitin 2009, është e përkushtuar në ngritjen profesionale dhe zhvillimin e kapaciteteve në përmbushje të misionit të saj kushtetues për zbatimin e operacioneve të reagimit ndaj krizave, mbështetjes së autoriteteve civile dhe ndihmës së qytetarëve të Republikës së Kosovës, pa dallim. FSK-ja është ngritur, zhvilluar dhe avancuar në një afat të shkurtër kohor, në harmoni me standardet e NATO-s dhe në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me partnerët tanë, duke u bërë kështu kontribut-dhënëse e sigurisë dhe institucioni më i besueshëm në vend në pesë vitet e fundit. Për më tepër, po vazhdojmë të punojmë që FSK-ja të bëhet forcë e ndërveprueshme, partner i besueshëm dhe kontribut- dhënëse e sigurisë në rajon dhe në botë, përkrah vendeve perëndimore.

Edhe gjatë këtij viti FSK-ja ka vazhduar me pastrimin e fushave nga mjetet e rrezikshme, duke demoluar dhe shkatërruar qindra mjete të pashpërthyera. Njëkohësisht, ka realizuar dhjetëra projekte humanitare në gjithë Kosovën, duke përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet e jetesës së qytetarëve të saj. Me kapacitetet e veta të kërkim-shpëtimit, atyre mjekësore dhe të tjera FSK-ja u ka qëndruar afër qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke i asistuar dhe duke ua dhënë ndihmën e nevojshme.

Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë shumetnike që pasqyron shumë etnitetin në Kosovë dhe ofron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim gjinie dhe etnie. Gjatë këtij viti kemi arritur numrin më të madh të rekrutëve nga komunitetet jo-shumicë.
Përgatitja për ushtrimin fushor 'Shqiponja 6", si ushtrimi më kompleks, me përfshirje të 12 vendeve partnere, po ecën drejt hapave përfundimtarë të planifikimit me qëllim të zbatimit në majin e vitit të ardhshëm. Planifikimi, organizimi dhe ekzekutimi i ushtrimit "Shqiponja Patrulluese" ka qenë një tjetër tregim suksesi, se si edhe me pak mund arrihen gjera të mëdha.

Forca e Sigurisë së Kosovës do të vazhdojë me zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve profesionale, në mënyrë që të jetë e gatshme të përmbushë misionin e saj për mbështetjen e autoriteteve civile dhe qytetarëve të Kosovës. Kemi bërë të gjitha planifikimet dhe përgatitjet e nevojshme për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës dhe tani jemi në pritje të vendimit. Forca e Sigurisë së Kosovës synon që së bashku me ndihmën e partnerëve të ndërtojë një forcë mbrojtëse profesionale, shumetnike, që do të jetë në të mirë të vendit dhe të gjithë qytetarëve të vendit dhe kontribut- dhënëse e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.

Ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të FSK-së, më lejoni të shpreh konsideratën time dhe të stafit për kontributin dhe shërbimin që jeni duke dhënë ndaj vendit. Ajo që ne bashkërisht kemi ndërtuar është projekti më i suksesshëm në shërbim edhe të brezave të ardhshëm. Me besimin e plotë se gjërat po lëvizin në drejtimin e duhur Ju uroj Ditën e Forcës dhe Ju përgëzoj për sukseset e arritura bashkërisht gjatë këtij viti.

Gjenerallejtnant Rrahman Rama
Komandant i FSK-së

Emërimi i zotit Rrustem Berisha ministër i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, më 11 shtator 2017, zyrtarisht u bë dorëzim-pranimi i detyrëssë ministrit të FSK-së.



Ministri i paraardhës zotëri Haki Demolli, i dorëzoi detyrën ministrit të ri zotit Rrustem Berisha. Ministri Rrustem Berisha pasi pranoi detyrën, falënderoi ministrin Demolli duke e përgëzuar për sukseset që ka shënuar kjo forcë dhe njëherësh konfirmoi përkushtimin e tij për të vazhduar punën me angazhim maksimal në drejtimin dhe realizimin e detyrave dhe projekteve të përgjithshme për Ministrinë dhe FSK-në.

Kryeministrit Ramush Haradinaj viziton Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës



Kryeministri i Republikës së Kosovës, zotëri Ramush Haradinaj, më 12 tetor 2017 është pritur me ceremoni ushtarake nga ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha. Ministri Berisha dhe kryeministri Haradinaj kanë zhvilluar një takim kokë më kokë dhe pastaj kanë vazhduar takimin e përbashkët, ku para kryeministrit dhe stafit të lartë të MFSK-së janë prezantuar të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Me këtë rast, Kryeministri i Kosovës z. Haradinaj ka falënderuar ministrin Berisha për pritjen dhe e ka përgëzuar për të arriturat e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Pas takimit të përbashkët, në paraqitjen para mediave, Kryeministri i Kosovës ka theksuar: “Kam ardhur në institucionin ku suksesi më i madh është besimi i qytetarëve të vendit në FSK-në dhe ky besim është për lakmi nga të gjitha institucionet e vendit. Sekreti i këtij besimi qëndron në besnikërinë në shërbim të të gjithë pjesëtarëve të Forcës; besnikëri në misionin që ata kanë për t’i shërbyer atdheut dhe qytetarëve. Po ashtu është një besnikëri ndaj aleatëve të Kosovës në temën e sigurisë, aleatëve që mund t’iu them dhe ta konfirmoj se më shumë se kurrë janë sot në Kosovë dhe në FSK me perspektiven e Kosovës, për t’i dhënë mandatin Kushtetues Ushtrisë së Kosovës”.

Ministri i FSK-së, z. Berisha, në fjalën e tij ka thënë: ”Ne, zotëri Haradinajn e njoftuam për së afërmi me të arriturat e FSK-së, aktivitetet dhe proceset të cilat i kemi kaluar deri me tani si dhe për procesin e transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Gjithashtu e njoftuam se ku kemi qenë, ku jemi dhe cilat janë sfidat që na presin në të ardhmen”.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës viziton Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha me ftesë të ministres së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, zonjës Olta Xhaçka, me 26 shtator 2017 ka qëndruar për vizitë zyrtare në Tiranë. Ministri Berisha dhe delegacioni i Ministrisë për FSK-në janë pritur në Ministrinë e Mbrojtjes me ceremoni ushtarake.

Në takimin e përbashkët të ministrit Berisha dhe ministres Xhaçka dhe të delegacioneve të tyre është biseduar për marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe shtetërore si dhe për bashkëpunimin e suksesshëm në mes dy ministrive.

Ministri Berisha duke folur për qëllimin e vizitës ka deklaruar: „Karakteri i kësaj vizite ishte më tepër njoftues dhe ka për qëllim ta zgjerojë bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe kjo është në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit rajonal të të gjitha vendeve të rajonit".

Ndërsa, ministrja Xhaçka në fjalën e saj qe shprehur se takimi ishte një mundësi e shkëlqyer për ta uruar zotin Berisha për detyrën e re në krye të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke shtuar: „Jam e bindur se zoti ministër, por edhe Qeveria e re e Republikës së Kosovës e drejtuar nga zoti Haradinaj do të vijojnë punën e shkëlqyer për integrimin e vendit të tyre në strukturat euroatlantike". „E sigurova zotin ministër se mbështetja jonë do të vijojë të jetë konkrete dhe maksimale si në rrafshin politik ashtu edhe në atë teknik. E gjithë eksperienca e Shqipërisë në rrugën e integrimit të plotë në NATO do të vijojë të përcillet me profesionalizëm dhe me dashamirësi tek vëllezërit tanë kosovarë".



Ministri Rrustem Berisha në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifaks të Kanadasë



Ministri i FSK-së z.Rrustem Berisha me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Kanadasë, z. HarjitSajjan, ka qenë pjesëmarrës në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifaks të Kanadasë. Forumi Ndërkombëtar për Siguri në Halifaks, është mbajtur për herë të nëntë, dhe ka pasur në me fokus bashkimin e liderëve të shteteve dhe personaliteteve më të larta nga shumë vende të botës. Ky Forum synon bashkëpunimin strategjik midis shteteve demokratike në botë. Pjesëmarrësit që mblidhen në Halifaks për çdo nëntor, përfaqësojnë më shumë se 60 shtete dhe mblidhen më shumë se 300 pjesëmarrës. Në Forumin e Halifaksit, ministri Berisha ka folur për perspektivën aktuale të Kosovës në sfidat më të cilat përballet rajoni ynë në fushën e sigurisë. Forumi Ndërkombëtar për Siguri në Halifaks është i njohur si një vendtakim vjetor, i cili krijon hapësirë që vendimmarrësit të gjejnë bashkërisht zgjidhje për rreziqet dhe kërcënimet me të cilat po përballet bota demokratike.

Gjatë qëndrimit në Halifaks, ministri Berisha ka mbajtur takime dypalëshe me homologë të vendeve mike dhe të NATO-s. Në kuadër të këtyre takimeve ministri Berisha ka pasur takime me ministrin e Mbrojtjes së Kanadasë, z. HarjitSajjan; ministrin e Mbrojtjes së Estonisë, z. Juri Luik dhe ministrin e Mbrojtjes së Zvicrës z. GuyParmelin. Ministri Berisha në këto takime dypalëshe ka theksuar nevojën e thellimit të bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe ministrive të Mbrojtjes të vendeve përkatëse, si dhe çuarjen përpara të marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes ministrive të këtyre vendeve.



Ministri Rrustem Berisha priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralin Giovanni Fungo



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), zotëri Rrustem Berisha priti për herë të parë në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralin GiovanniFungo. Në takimin e ministrit Berisha dhe gjeneralit Fungo u bisedua për situatën e sigurisë në vendin tonë dhe gjithashtu për bashkëpunimin e mirë ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Trupave Paqeruajtëse të KFOR-it, si dhe për planet dhe aktivitetet konkrete për bashkëpunim në të ardhmen. Me këtë rast, ministri Berisha u shpreh se, gjatë mandatit të tij, do të angazhohet që t'i avancojë më tutje marrëdhëniet e shkëlqyera dhe të kultivuara deri më tani në mes Ministrisë për FSK-në dhe KFOR-it.

Komandanti i Trupave Paqeruajtëse të KFOR-it, GiovanniFungo, tha se KFOR-i dhe FSK-ja kanë raporte bashkëpunimi shumë konkrete, jo vetëm me takime e shkëmbime zyrtare, por edhe me ushtrime dhe aktivitete tjera të përbashkëta fushore, në të cilat njësi të veçanta të KFOR-it dhe të FSK-së kryejnë stërvitje të përbashkëta.

Ministri Haki Demolli ka pasur takim me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jans Stoltenberg

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama kanë zhvilluar një takim të përbashkët me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, JansStoltenberg. Gjatë takimit është biseduar për situatën e sigurisë në vendin tonë, hapat që duhet të ndërmerren lidhur me ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit të Kosovës, si dhe për zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës. Nga ana e tij, ministri Demolli e ka njoftuar Sekretarin e NATO-s, JansStoltenberg mbi zhvillimin dhe profesionalizimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, avancimin e saj në drejtim të përmbushjes së misionit të saj në mbështetje të institucioneve dhe qytetarëve të vendit, krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për përfshirjen e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu, ministri Haki Demolli, duke shprehur mirënjohje për angazhimin e NATO-s për paqe në Kosovë përmes trupave të KFOR-it, ka thënë se aktualisht Republika e Kosovës është duke u përpjekur seriozisht që të zhvillojë dhe konsolidojë mekanizmat e saj të sigurisë



për të ardhmen, gjithnjë bazuar në konsensus politik të brendshëm dhe në koordinim me faktorin ndërkombëtar. Nga ana e tij Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, z. Stoltenberg, ka deklaruar mbështetje të parezervë për FSK-në përmes Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (EKNN), brenda misionit dhe kapaciteteve të saj, duke shprehur konsideratë të lartë dhe profesionalizëm në angazhimin e saj të treguar deri më tani.

Komandanti i FSK-së dhe drejtori i NALT-it raportuan në Komitetin për Operacione dhe Politika të NATO-s në Bruksel

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, së bashku me drejtorin e NALT-it (Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në), gjeneral brigade DietmarMosmann, kanë qëndruar për vizitë dyditore zyrtare në Shtabin e NATO-s në Bruksel, përkatësisht në Komitetin për Operacione dhe Politika.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama para këtij komisioni ka raportuar për bashkëpunimin me NALT-in dhe NATO-n, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së gjatë vitit 2016 dhe për vizionin dhe objektivat e FSK-së për të ardhmen. Ndërsa, gjenerali DietmarMosmman, drejtori i NALT-it, ka raportuar për zhvillimin e NALT-it, mbështetjen dhe bashkëpunimin me FSK-në si dhe për detyrat në të ardhmen.

Ndërkaq, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka zhvilluar takime edhe me disa përfaqësues të NATO-s dhe me kryesuesin e takimit të Komitetit për Operacione dhe Politika, z. MichelSoula. Prezantimet e gjeneral Ramës dhe gjeneral Mosmann janë mirëpritur nga të pranishmit në komitet, madje ata edheu inkurajuan nga përfaqësuesit e këtij komiteti për të arriturat e deritashme dhe për vizionin e tyre për zhvillimin e FSK-së në të ardhmen.

Ministri Demolli ka pritur zëvendës-ndihmësin e Sekretarit Amerikan të Shtetit për çështje evropiane dhe euro-aziatike, Hoyt Brian Yee



Ministri i FSK-së, zotëri Haki Demolli, ka pritur zëvendës-ndihmësin e Sekretarit Amerikan të Shtetit për çështje evropiane dhe euro-aziatike, z. HoytBrianYee. Pjesëmarrës në takim ishinzëvendësministri Muhamet Latifi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kurse zotin Yee e shoqëronin atasheu ushtarak i SHBA-ve, në Prishtinë, kolonel Jeffrey H. Fisher dhe këshilltari ushtarak Joshua Rubin.

Me këtë rast, ministri Haki Demolli, në emër të Ministrisë dhe FSK-së e ka falënderuar zëvendës-ndihmësin e Sekretarit Amerikan të Shtetit për çështje evropiane dhe euro- aziatike, z. HoytYee, për ndihmën që SHBA-të po japin për FSK-në, duke vlerësuar lartë bashkëpunimin e dy shteteve dhe në veçanti Partneritetin e Bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Ajovës. Nga ana e tij, zëvendës- ndihmësi i Sekretarit Amerikan të Shtetit për çështje evropiane dhe euro- aziatike, z. HoytYee, ka falënderuar ministrin Demolli për pritjen dhe ka përcjellë mesazhin se Uashingtoni zyrtar është i shqetësuar rreth procesit të transformimit të FSK-së me ligj.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama në Departamentin e Mbrojtjes dhe në Kongresin e SHBA-ve



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA), i shoqëruar nga komandanti i Gardës Kombëtare të shtetit të Ajovës gjeneral major TimothyOrr.

Gjatë vizitës, gjenerallejtënant Rrahman Rama i shoqëruar nga një delegacion i FSK-së ka zhvilluar takime të nivelit të lartë në Departamentin e Mbrojtjes, në Departamentin e Shtetit dhe në Kongresin amerikan. Gjeneral Rama fillimisht është takuar me kongresistët PaulCook dhe SteveKing si dhe me zëvendëskomandantin e Byrosë së Gardës Kombëtare të SHBA-ve, gjenerallejtënant DanHokanson.

Më pas gjeneral Rama ka takuar edhe ndihmës-sekretaren e Mbrojtjes për Rusi, Ukrainë dhe Euro-Azi, Laura Cooper. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i shoqëruar edhe nga ambasadorja e Kosovës në SHBA, ka mbajtur një takim edhe me z. MattPalmer, drejtor i Zyrës për Çështje të Evropës Jug-Qendrore në Departamentin e Shtetit.

Komandanti i FSK-së, në të gjitha takimet e tij ka ritheksuar partneritetin dhe mbështetjen që SHBA po i jep FSK-së në zhvillimin dhe profesionalizimin e saj në të gjitha fushat. Ai po ashtu ka informuar nivelin e lartë të Mbrojtjes të SHBA-ve lidhur me procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura(FAK).

Në kuadër të kësaj vizite KOMFSK ka takuar edhe pjesëtarët e FSK-së dhe të Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët ishin pjesëmarrës në vrapimin vjetor tradicional të Ushtrisë Amerikane "10 miler".

Komandanti i FSK-së ka pritur Komandantin Suprem të Forcave Aleate për Evropë

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka pritur Komandantin Suprem të Forcave Aleate për Evropë, njëherësh edhe Komandant i Komandës së SHBA-ve për Evropë, gjeneralin Curtis M. Scaparrotti të shoqëruar nga komandanti i KFOR-it, gjeneral majori GiovanniFungo.

Në takimin e përbashkët të gjeneral Ramës dhe gjeneralit Scaparrotti, është biseduar për çështjet e sigurisë në Republikën e Kosovës, në rajon dhe më gjerë. Gjithashtu është biseduar edhe për profesionalizimin e institucioneve të sigurisë të vendit tonë, si dhe për zhvillimin dhe avancimin e marrëdhënieve të FSK-së me KFOR-in dhe NATO-n, në përgjithësi.

Në këtë takim, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama ka falënderuar komandantin Suprem të Forcave Aleate për Evropë, gjeneralin Scaparrotti për angazhimin e NATO-s nëpërmjet KFOR-it, në ruajtjen e paqes dhe garantimin e sigurisë në Kosovë, si dhe për rolin e NATO-s, nëpërmjet Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për këshillimin dhe zhvillimin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Nga ana e tij, Komandanti Suprem i Forcave Aleate të NATO-s për Evropë, gjeneral Curtis Scaparrotti ka



shprehur përgëzime për lidershipin, profesionalizimin si dhe bashkëpunimin e mirë që FSK-ja ka me KFOR-in, për angazhimet e saj, në të mirë të komunitetit dhe zhvillimit të Kosovës në përgjithësi duke premtuar përkrahjen e NATO-s për ushtrimet fushore dhe stërvitjet e përbashkëta, trajnime dhe operacione si dhe shkollim profesional të pjesëtarëve të FSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur shefin e Komandës Amerikane për Operacione Speciale në Evropë, gjenerallejtënant Mark Schwartz

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur shefin e Komandës Amerikane për Operacione Speciale në Evropë, gjenerallejtënant Mark Shchwartz.

Në takimin e përbashkët, komandanti i FSK-së e ka njoftuar gjeneralin Shchvarc me zhvillimin dhe të arriturat e FSK-së, operacionet, trajnimet, shkollimet si dhe përgatitjet që janë bërë dhe po bëhen për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Gjithashtu, gjenerallejtënant Rrahman Rama i ka paraqitur gjeneralit amerikan nevojën që Komanda Amerikane për Operacione Speciale në Evropë, ta mbështesë FSK-së në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të saja aktualesi dhe kapaciteteve të mbrojtjes për Forcën e Armatosur të Kosovës.

Nga ana e tij, shefi i Komandës Amerikane për



Operacione Speciale në Evropë, gjenerallejtënant Mark Shchwartz ka shprehur gatishmërinë që FSK-në ta mbështesë me trajnime dhe shkollime, për kapacitetet aktuale që FSK-ja ka aktualisht, si në fushë e kërkim-shpëtimit etj., si dhe është shprehur se do të analizohen mundësitë dhe do të identifikohen fushat e mbështetjes edhe për të ardhmen.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama në Asociacionin e Ushtrisë së SHBA-ve



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama i shoqëruar nga një delegacion i FSK-së dhe ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA), zonja Vlora Çitaku, kanë qenë pjesë në ceremoninë e hapjes së takimit vjetor të Asociacionit të Ushtrisë së SHBA-ve (AUSA).

Në ceremoni ishin të pranishëm Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, JimMattis, si dhe shumë delegacione ushtarake nga mbi 70 shtete. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Mattis, në fjalën e tij, kryesisht, ka theksuar sfidat e sigurisë globale.

Komandanti i FSK-së, me këtë rast, ka zhvilluar edhe një varg takimesh të rëndësishme si me shefin e Shtabit të Ushtrisë Amerikane, gjeneral Mark A. Milley dhe me shumë shefa të shtabeve të ushtrive të cilët ishin pjese në AUSA.

Në Uashington, gjeneral Rama ishte takuar edhe me komandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Ben Hodges, me ç 'rast kanë diskutuar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama në Konferencën e Partneritetit Ndërshtetëror me Gardat Kombëtare të SHBA-ve



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka marrë pjesë në Konferencën e Partneritetit Ndërshtetëror me Gardat Kombëtare të SHBA-ve. Kjo konferencë dyditore është mbajtur në Garmish të Gjermanisë nën patronatin e Komandës Evropiane të SHBA-ve.

Në këtë konferencë kanë marrë pjesë shefat e ushtrive të Evropës të cilat kanë partneritet ndërshtetërorë si dhe komandantët e gardave kombëtare të shteteve partnere. Në këtë takim ka qenë prezent edhe gjeneralmajor TimothyOrr, komandant i Gardës Kombëtare të Ajovës, me të cilën FSK-ja ka të nënshkruar partneritet për bashkëpunim të gjerë dhe intensiv.

Qëllimi i kësaj konference ishte rritja e aktiviteteve të përbashkëta, sinkronizimi i bashkëpunimit, rritja e rolit të shteteve partnere në forcimin e partneritetit shtetëror dhe arritja e ndërveprimit në mes Ushtrive të Shteteve të Evropës dhe Forcave të Armatosura të SHBA-ve në ballafaqim me sfidat bashkëkohore.

Komandanti i FSK-së dhe Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës vizitojnë njësitë e FSK-së

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës(Iowa), gjeneral major TimothyOrr i shoqëruar nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës,gjenerallejtënant Rrahman Rama, kanë vizituar Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj si dhe Batalionin e Parë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Gjilan.

Në kazermën „Skënderbeu “ në Ferizaj delegacionet janë pritur nga komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi me stafin e tij dhe janë njoftuar për aktivitetet të cilat është duke i zhvilluar KDS-ja, përgatitje dhe prioritete këto të dhëna nga Komandanti i FSK-së për Komandën e Doktrinës si institucion edukativ dhe me prioritet në fazën e transformimit.



Gjenerali Orr në KDS ishte shumë i interesuar për të gjitha proceset që po kalon FSK-ja si; trajnimet, infrastruktura, përgatitja e stafit dhe shumë çështje tjera me interes. Vizita ka vazhduar në përcjelljen e disa trajnimeve që janë duke u realizuar në KDS.

Gjenerali Orr ka takuar gjithashtu dy pjesëtarët e FSK-së, të cilët kishin dalë të parët në garën e „Ushtarit më të mirë për vitin 2017”, tetar Rafet Gashi, tetar BinakPodrimqaku, ku u ka ndarë nga një mirënjohje për të arriturat e tyre dhe i ka përgëzuar për suksesin.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në Konferencën "SHBA-Karta e Adriatikut A-5"



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama ka marrë pjesë në Konferencën e 21-të të shefave të shtabeve të ushtrive të vendeve pjesëmarrëse "SHBA-Karta e Adriatikut A-5", e cila është mbajtur në Shkup të Maqedonisë. Temë kryesore e konferencës ishte "Zgjerimi i bashkëpunimit midis anëtarëve të Kartës së Shteteve të Bashkuara dhe Adriatikut (A-5) për integrimin e plotë në NATO dhe kontributi në sigurinë e Aleancës". Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, në paraqitjen e tij në punimet e Konferencës „SHBA-Karta e Adriatikut(A5)" të mbajtur në Shkup, ka theksuar nevojën për zgjerimin e bashkëpunimit në nivel rajonal, me qëllim të rritjes së ndërveprimit, besimit dhe shkëmbimit të përvojave në sektorin e Sigurisë dhe atë të Mbrojtjes.

Gjeneral Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral major TimothyOrr, të shoqëruar nga atasheu ushtarak amerikan, kolonel JefryFischer kanë zhvilluar takim të përbashkët me zëvendëskomandantin e Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë (EUCOM), gjenerallejtënant Timothy M. Ray, ku kanë diskutuar për mundësinë e zgjerimit të aktiviteteve të përbashkëta. Komandanti i FSK-së, gjithashtu ka pasur takime bilaterale me shefat e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe drejtorin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kroate, kundëradmiralin Robert Hranj, me të cilët është pajtuar për krijimin e mundësive më të mëdha në shkëmbimin e përvojave në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe bilateral.

Shefat e shtabeve të ushtrive të vendeve pjesëmarrëse në takimin e 21-të "SHBA-Karta e Adriatik A-5", kanë nënshkruar një deklaratë të përbashkët, që konfirmon vendosmërinë e fortë për të forcuar edhe më tej marrëdhëniet dhe për të zgjeruar dhe thelluar fushat e bashkëpunimit ushtarak, me qëllim të mbështetjes dhe forcimit të sigurisë rajonale.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama ka vizituar Forcat e Armatosura të Turqisë



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të komandantit të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneral HulusiAkar, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Ankara.

Gjeneral Rama, në Ankara, është pritur me nderime ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë nga Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë së Turqisë, gjeneral HulusiAkar.

Gjeneral Rama dhe gjenerali Akar, gjatë takimit, kryesisht kanë biseduar për marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimin e suksesshëm dypalësh në mes Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Turqisë si dhe për planet e bashkëpunimit në të ardhmen.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, ka vlerësuar lart mbështetjen që Ushtria Turke është duke dhënë në të gjitha fushat për FSK-në, në mënyrë që FSK-ja të vazhdojë zhvillimin dhe profesionalizimin e saj të gjithanshëm. Ai njëherësh ka nënvizuar përkushtimin e Komandantit të Forcave të Armatosura të Turqisë gjeneralit Akar për mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së në pajisje dhe në fushën e arsimit dhe trajnimit profesional.

Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë vizitë zyrtare në FSK



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur shefin e Shtabit të Ushtrisë të Republikës së Maqedonisë, gjenerallejtënant MetodijaVelickovski, në krye të një delegacioni të lartë të Ushtrisë së Maqedonisë.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe ministri Haki Demolli, ku ishte edhe zëvendësministri Muhamet Latifi, kanë zhvilluar takime të ndara me shefin e Ushtrisë së Maqedonisë, gjeneralin Velickovski, të cilin e kanë falënderuar për bashkëpunimin e deritashëm ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë së Maqedonisë, si dhe e kanë njoftuar me të arriturat e përgjithshme të FSK-së.

Po ashtu, ministri dhe komandanti janë shprehur se marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë dhe FSK-së me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ushtrinë e Maqedonisë janë në nivel të lartë dhe kanë treguar gatishmëri për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi, duke u bazuar në raportet e mira ekzistuese dhe në konkretizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy forcave dhe të dy vendeve.

Komandanti i FSK-së gjeneral Rama me shefin e Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë, gjeneralin Velickovski së bashku me dy delegacionet, kanë përcjellë nga afër demonstrimin e pjesëtarëve të Kërkim-Shpëtimit Urban. Ndërsa shefi i Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë, gjenerallejtënant MetodijaVelickovski, ka shprehur kënaqësi të veçantë për bashkëpunimin e mirë ndërmjet Ushtrisë së Maqedonisë dhe FSK-së si dhe ka përgëzuar pjesëtarët e FSK-së për demonstrimin e tyre me sukses.

Ministria e FSK-së ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë



Drejtori i Departamentit për Politika dhe Plane në Ministrinë e FSK-së, z. Faruk Geci është pritur në një takim pune nga drejtori i Politikave të Mbrojtjes të Ministrisë së Mbrojtjes së Sllovenisë në Lubjanë, z. Mishmas.

Me këtë rast, të dy drejtorët kanë nënshkruar Planin dypalësh të bashkëpunimit midis Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë dhe Ministrisë për FSK-në për vitin 2017, i cili plan parasheh një mori aktivitetesh në fushën e shkollimit, trajnimeve të ndryshme si dhe pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrime të përbashkëta.

Të dy palët kanë biseduar edhe për format e mundshme të bashkëpunimit lidhur me shkollimin e pjesëtarëve të FSK-së në këtë qendër. Sipas marrëveshjes, për këtë vit, katër pjesëtarë të MFSK/FSK-së do t'i ndjekin kurset e avancuara të gjuhës angleze në Slloveni.

Sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj në Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë



Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, nga data 27-30 gusht 2017, me ftesë të Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS), dhe delegacioni në përbërje të drejtorëve të departamenteve dhe koordinatorit të projekteve të CIDS-it për Kosovë, z. Florian Qehaja kanë qëndruar për një vizitë zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë.

Gjatë qëndrimit treditorë, autoritetet e CIDS-it dhe zyrtarët nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ombudspersoni i Forcave të Armatosura norvegjeze kanë ndarë përvojat e tyre me delegacionin e MFSK-së, për praktikat institucionale të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Forcave të Armatosura(FA) si dhe institucioneve tjera përkatëse nga fusha e ndërtimit të integritetit në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë, fusha e diplomacisë dhe fusha e avokimit mbi të drejtat e pjesëtarëve të Forcave të Armatosura.

Në kuadër të agjendës, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj dhe drejtori i CIDS–it, z. Per Christensen janë pritur nga homologu i tij, z. Arne Røksund, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë.

Me këtë rast, sekretari Sylaj, në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka falënderuar homologun e tij, për mbështetjen e vazhdueshme të shtetit dhe popullit norvegjez, që nga paslufta në fusha të ndryshme si dhe për procesin aktual të zhvillimit të MFSK–së dhe FSK–së, konkretisht përkrahjen me dy projekte tri-vjeçare në fushën e ndërtimit të integritetit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore të mbështetura nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes. Gjithashtu, z. Sylaj, ka falënderuar homologun e tij për mirëkuptimin e dëshmuar për vazhdimin e projekteve përkatëse edhe për tri vitet e ardhshme. Me qëllim të zgjerimit dhe thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit bilateral në mes të MFSK–së dhe MM dhe FA të Norvegjisë edhe në fusha të tjera, sekretari Sylaj ka kërkuar nga homologu i tij shqyrtimin e propozimit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes dy ministrive përkatëse.

Drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane z. Faruk Geci në takimin e shefave për politika dhe plane SHBA-Karta e Adriatikut

Drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Faruk Geci, ka marrë pjesë në takimin e drejtorëve të drejtorive për politika të mbrojtjes të shteteve anëtare të SHBA-Karta e Adriatikut (A5), i cili është mbajtur në Shkup të Republikës së Maqedonisë. Në takimin e zyrtarëve të lartë për politika të mbrojtjes është diskutuar për projektet aktuale në kuadër të Kartës së Adriatikut-A-5, për projektet e reja në të ardhmen, për kontributin e vendeve të rajonit në misionet e NATO-s si dhe për krizën e refugjatëve. Me këtë rast, drejtori Geci, para përfaqësuesve të vendeve anëtare, ka paraqitur argumentet për mbështetje të kërkesës për pranimin e Republikë së Kosovës si anëtare me të drejta të plota në forumin e Kartës së Adriatikut-A5. Ai po ashtu ka folur edhe për projektet konkrete që mund të realizohen bashkërisht në të ardhmen në fushën e kërkim- shpëtimit duke ofruar për vendet e rajonit, Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të Regjimentit të Mbrojtjes Civile, ndërsa për kadetët e vendeve fqinje, mundësinë e përfshirjes së tyre në të ardhmen në Qendrën për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Konferenca “FSK dhe Partnerët - 2017”



I. Konferenca e 6-të ,,FSK dhe Partnerët”

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK) ka zhvilluar punimet konferenca e gjashtë me radhë „FSK dhe Partnerët”, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të ushtrive të vendeve partnere të MFSK-së dhe FSK-së dhe institucioneve vendore të fushës së sigurisë.

Me këtë rast, në fjalën e hapjes së punimeve të konferencës, ministri Haki Demolli ka thënë se qëllimi i konferencës „FSK dhe Partnerët” është rritja e bashkëpunimit të MFSK/FSK-së dhe shteteve partnere si dhe sinkronizimi i aktiviteteve, në mënyrë që MFSK-ja dhe FSK-ja të kenë mbështetje për t’u zhvilluar në Forcë të aftë dhe profesionale.
Ndërsa, në fjalën e tij komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka falënderuar atashetë ushtarakë të vendeve partnere, pjesëmarrëse në konferencë, për kontributin e vazhdueshëm që vendet e tyre kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin për ndërtimin, zhvillimin dhe profesionalizmin e FSK-së.

Me nga një fjalë përshëndetëse në konferencë janë paraqitur edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral GiovaniFungo dhe drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për MFSK/FSK-në, gjeneral DietmarMosmann.

II. Konferenca e 7-të ,,FSK dhe Partnerët”



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), më 23 tetor 2017 është zhvilluar edicioni i 7-të i konferencës „FSK dhe Partnerët”, ku kanë marrë pjesë atashetë ushtarakë dhe ata të mbrojtjes, përfaqësues të ambasadave të shteteve me të cilat MFSK-ja ka bashkëpunim bilateral dhe multilateral.

Punimet e konferencës i ka shpallur të hapura ministri i FSK-së, Rrustem Berisha i cili ka thënë se konferenca e 7-të „FSK dhe Partnerët” përkon me fillimin e mandatit të tij si ministër, dhe se qëllimi i tij është intensifikimi i bashkëpunimit të ndërsjellë bilateral të FSK-së dhe shteteve partnere si dhe harmonizimi i aktiviteteve që kanë për qëllim mbajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të FSK-së.
Ministri Berisha po ashtu ka njoftuar ushtarakët dhe diplomatët e vendeve partnere mbi planifikimin për të ardhmen e FSK-së, ku ndër të tjera ka thënë: “Ne jemi duke punuar në përgatitjen dhe planifikimin e ndryshimit të misionit tonë, respektivisht në ngritjen e kapaciteteve tona për misionin e ri kushtetues.”

Ndërsa, gjenerali i FSK-së Rrahman Rama ka thënë se roli i partnerëve ka ndikim të madh në avancimin e kapaciteteve të FSK-së. “Ne jemi institucioni më i besueshëm në pesë vitet e fundit. Ky është një privilegj, por në të njëjtën kohë dhe përgjegjësi t’i mbajmë standardet tona në nivelin më të lartë. Në konferencën e parë të FSK-së me partnerët, që është mbajtur në muajin prill, qëllimi ishte t’i prezantojmë tek ju nevojat tona për zhvillim të mëtutjeshëm të kapaciteteve të FSK-së dhe po ashtu t’i sinkronizojmë të gjitha aktivitetet me ju, në mënyrë që të kemi një qasje më të mirë në objektivat e përbashkëta, në procesin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur”.

Gjithashtu me nga një fjalë rasti, në punimet e konferencës janë prezantuar edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral GiovaniFungo dhe drejtori i Ekipit Këshillues të NATO-s për FSK-në(NALT), gjeneral brigade RalfHoffman. Gjeneral Fungo, ka shprehur vlerësimin e tij për profesionalizmin e FSK-së.

Për herë të parë, në Konferencën „FSK dhe Partnerët”, kanë marrë pjesë edhe oficerë nga Ministria e Mbrojtjes së Malit të Zi, krahas diplomatëve ushtarakë nga shtetet partnere si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Shqipëria, Maqedonia, Turqia, Japonia, Holanda, Gjermania, Italia, Kroacia, Belgjika etj. Konferenca ka vazhduar punimet dy ditë. Në ditën e saj të dytë është vizituar Batalioni i Parë i Reagimit të Shpejtë në Gjilan.



FSK-ja përkujton 11 shtatorin e sulmeve terroriste në SHBA



Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë përkujtuan viktimat e 11 shtatorit të vitit 2001, të sulmeve terroriste mbi popullatën amerikane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më 11 shtator 2017, në të gjitha njësitet e FSK-së, me organizime të ndryshme janë nderuar viktimat e sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Po ashtu edhe në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, pjesëtarët e FSK-së së bashku me pjesëtarët amerikanë të Kampit Bonstill, edhe këtë vit, si çdo vit tjetër, kanë përkujtuar me nderim viktimat e sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe i tërë populli i Kosovës ndajnë dhimbjen me popullin amerikan, i cili në çdo vend të botës kontribuon për paqe e liri.

Ministri dhe komandanti i FSK-së kanë nderuar sakrificën e ushtarakëve britanikë të rënë në Kosovë

Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me oficerë të lartë të FSK-së, në ceremoninë e ri-dedikimit të Memorialit të ri Britanik, kanë nderuar dhe përkujtuar 14 ushtarakët e Mbretërisë së Bashkuar të rënë në Kosovë. Krerët e FSK-së dhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar RuairiO'Conell, të shoqëruar edhe nga oficerë britanikë, kanë bërë homazhe duke u përkulur me respekt dhe mirënjohje pranë memorialit të të rënëve, ku po bënin nderime pjesëtarët e Togut Ceremonial të FSK-së. Me këtë rast, ambasadori O'Connell, veç tjerash është shprehur: „14 ushtarët britanikë, emrat e të cilëve



në këtë memorial do të mbahen në mend përgjithmonë, që dhanë jetën e tyre në mënyrë që Kosova të mund të njohë paqen. Sakrifica e tyre është lidhja më e fortë dhe e pathyeshme midis vendeve tona". Ceremonia e mbajtur në nderimi të ushtarakëve britanikë është mbështetur edhe nga Bendi Muzikor dhe Togu Ceremonial i FSK-së.

FSK shenoi 19 - vjetorin e Epopesë së UÇK-së



Në kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës, është shënuar 19-vjetori i Epopesë së UÇK-së, në nderim të Komandanti Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit. Kanë marrë pjesë presidenti i Kosovës z. Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, udhëheqës shtetëror dhe përfaqësuesi i veteranëve të UÇK-së.


Në manifestimin "Epopeja e UÇK-së", kryetari Hashim Thaçi, në fjalën e tij, pos tjerash ka thënë: "Kushtetuta moderne e Kosovës, mua si Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë së Kosovës më jep kompetenca të mjaftueshme për të ndërmarr iniciativa për të ndryshuar ligjin për FSK-në". "Para nesh të nderuar qytetarë janë rreshtuar pjesëtarët e FSK-së e që për mua si Komandant Suprem, dhe mbi të gjitha për ju qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, këta janë ushtarët dhe oficerët e Ushtrisë së Republikës së Kosovës. Asnjë qëndrim i caktuar i qarqeve jo dashamirëse nuk mund ta njollosë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Ajo mbetet trashëgimia jonë më e madhe dhe më e pasur që ka krijuar historia e Kosovës. Ashtu siç do të jetë e përjetshme dhe e vlerësuar lart sakrifica sublime e Jasharëve dhe gjithë dëshmorëve të Kosovës, ashtu do të jetë i përjetshëm lavdia dhe emri i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj të nderuar ushtarë të FSK-së, unë sot dua të bëj të qartë publikisht se në ditët në vijim shumë shpejt, brenda kompetencave të mia kushtetuese, do të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme ligjore që transformimi i shumë pritur i themelimit të Ushtrisë së Kosovës të bëhet edhe nëpërmjet ndryshimit të ligjit për FSK-në", e përmbylli fjalën e tij, kryetari i Kosovës Hashim Thaçi.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa në fjalën e tij, ndër të tjera ka theksuar: "Epopeja e UÇK-së" për çdo qytetar të Kosovës është festë e lirisë së Kosovës, është kremtja e vlerave të atdhedashurisë, patriotizmit dhe sakrificës sublime për Kosovën. Kosova, institucionet e saj, si dhe qytetarët kanë sfidat e veta, që janë të shumta dhe të cilat ndryshojnë krahas prosperitetit tonë. Kosova ka bërë transformime epokale dhe historike, falë rezistencës së saj paqësore, unike për këtë pjesë të botës, falë luftës çlirimtare të popullit të saj".

Në përfundim të manifestimit janë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz, dhe është mbajtur Akademia Përkujtimore kushtuar "Epopesë së UÇK-së".

MministriDemolli dhe komandanti Rama bënë homazhe në Gllogjan

Ministri Haki Demolli, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministri Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj dhe oficerë të lartë dhe komandantë të njësive të FSK-së kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora lulesh në Memorialin e Dëshmorëve të Kombit në Gllogjan, në kuadër të shënimit të 19- vjetorit të 24 Marsit- „Epopeja e Dukagjinit". Delegacioni i FSK-së me këtë rast në Gllogjan ka nderuar sakrificën e Familjes Haradinaj, dëshmorëve të Dukagjinit si dhe sakrificën e të gjithë popullit për Liri. Gjithashtu kjo ditë shënon edhe 18-vjetorin e fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet ushtarake të ish Jugosllavisë(Serbi dhe Mali i Zi).



Ministri Demoli dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama bënë homazhe në Koshare



Ministri Haki Demoli dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së) gjenerallejtënant Rrahman Rama të shoqëruar nga zëvendësministri Muhamet Latifi, kanë marrë pjesë në manifestimin "Ditët e shqipes" që i kushtohet të rënëve të "Brigadës 138 Agim Ramadani", në betejën e UÇK-së në Koshare dhe së bashku me bashkëpunëtorë bënë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Koshare. Po ashtu ata kanë takuar shumë familjarë të dëshmorëve dukeshprehur mirënjohjen për sakrificën sublime të dëshmorëve të rënë në altarë të lirisë në luftën çlirimtare dhe respektin për pasardhësit dhe familjarët e tyre. Ata kanë vlerësuar lartë të rënët në këtë betejë të lavdishme e cila theu kufirin e imponuar forcërisht ndërmjet shqiptarëve, betejë që së bashku me të gjitha betejat e luftës së UÇK-së i sollën lirinë Kosovës. Pjesë e delegacionit ishin edhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës Tokësore të FSK-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj shef i departamentit të Operativës dhe Trajnimeve, kolonel Fadil Hadergjonaj këshilltar ushtarak i ministrit, këshilltarët politikë Rexhep Leci dhe Shkelzen Feka.

FSK ndëron të rënët në Reçak



Ministri i FSK-së, Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me stafin e lartë të MFSK/FSK-së, kanë marrë pjesë në shënimin e përvjetorit të 18-të, të Masakrës së Reçakut, në Reçak, ku kanë nderuar të gjithë martirët e dhe të rënët për Liri. Ministri Haki Demolli, së bashku me kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, Isa Mustafa, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule në Kompleksin e Reçakut, ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me zëvendësministrin , z. Muhamet Latifi dhe me stafin e lartë të Ministrisë dhe FSK-së, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur lule në varrezat e Reçakut, duke nderuar të gjithë martirët dhe dëshmorët në Reçak. Ministri Demolli, me këtë rast, ka çmuar lartë sakrificën e reçakasëve si dhe ka vlerësuar lartë kontributin e tyre për Lirinë e Kosovës.

Mministri Demolli dhe komandant Rama bënë homazhe në Gllogjan

Ministri Haki Demolli, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministri Muhamet Latifi, sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj dhe oficerë të lartë dhe komandantë të njësive të FSK-së kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora lulesh në Memorialin e Dëshmorëve të Kombit në Gllogjan, në kuadër të shënimit të 19- vjetorit të 24 Marsit- ,,Epopeja e Dukagjinit". Delegacioni i FSK-së me këtë rast në Gllogjan ka nderuar sakrificën e Familjes Haradinaj, dëshmorëve të Dukagjinit si dhe sakrificën e të gjithë popullit për Liri. Gjithashtu kjo ditë shënon edhe 18-vjetorin e fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet ushtarake të ish Jugosllavisë (Serbi dhe Mali i Zi).



FSK-ja përfundon stërvitjen shumëkombëshe ,,KFOR 23" në Gjermani



Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), i përbërë prej 16 pjesëtarëve, një skuadër e Kompanisë për Mbrojtje Kimike – Biologjike - Atomike (MKBA) dhe një për Eliminimin e Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyera (EOD) e Kompanisë së Deminimit, si dhe dy vëzhgues –kontrollues, kanë marrë pjesë në ushtrimin e përbashkët ,,KFOR 23" në Bazën e Ushtrisë Amerikane për Evropë (USAREUR), në Qendrën e Bashkuar Shumëkombëshe për Gatishmëri (JMRC), në Hohenfild të Republikës Federale të Gjermanisë. Për të parë nga afër operacionet përfundimtare të ushtrimit ,,KFOR 23" të kontingjentit të FSK-së, në mesin e shumë personaliteteve ka qenë edhe gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i cili gjatë kohës sa kishte përcjell këto operacione të pjesëtarëve në këtë ushtrim kishte marr komente dhe vlerësime shumë të larta për angazhimin, disiplinën dhe profesionalizmin që kishin treguar pjesëtarët e FSK-së. Gjatë aktiviteteve trajnuese dhe stërvitore të ushtrimit, Ekipi i EOD-së ka pasur për mision që të detektojë dhe shkatërrojë mjetet e pashpërthyera, ndërsa skuadra e MKAB-së të bie në kontakt me autoritetet lokale për të bërë vlerësimin e zonës së kontaminuar.

Pjesëtarë të FSK-së përfundojnë me sukses trajnimin për kërkim-shpëtim në Republikën e Kroacisë



Në kuadër të bashkëpunimit bilateral mes Republikën e Kroacisë dhe Kosovës dhe në kuadër të saj edhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Kroacisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), një ekip i pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga Regjimenti i Mbrojtjes Civile (Task Forca e Kërkim-Shpëtimit) kanë realizuar trajnimin e kërkim-shpëtimit në male në Republikën e Kroacisë. Ky trajnim është realizuar në bashkëpunim me Forcat e Armatosura të Republikës së Kroacisë, njësinë Speciale Kroate për Kërkim-Shpëtim në male, me temën: "Ripelim(me litarë), Kërkim-Shpëtim dhe Evakuim me Helikopter". Trajnimi i nivelit të tillë për pjesëtarët e FSK-së, ka një rëndësi të veçantë për krijimin e bashkëpunimit dhe përvojave që ka Ushtria Kroate në lëmin e kërkim-shpëtimit në të gjitha fushat: si kërkim-shpëtim në male, në dete dhe atë urban.

Pjesëtarë të FSK-së certifikohen Instruktorë të Trajnimit Fizik në Britani të Madhe

Gentiana Karpuzi u bë e para femër ushtare jo angleze, që përfundoi tërësisht kursin e Ushtrisë britanike për instruktortë trajnimit fizik, në Shkollën Ushtarake të Trajnimit Fizik në Angli . Ky kurs rigoroz tridhjetë (30) javorë është i hapur vetëm për ushtarët më të mirë të Ushtrisë së Britanisë të cilët dëshirojnë të specializohen në fushën e trajnimit fizik. Po ashtu edhe pjesëtari Emir Vllasa, ka përfunduar "Kursin e instruktorit të trajnimit fizik të të gjitha armëve". Në këtë kurs studentët mësojnë të ngritin programe të trajnimit fizik dhe të udhëheqin seanca të trajnimit në palestër.



Behar Fazliu shpallet kadeti më i mirë ndërkombëtar në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore



Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, nëntogeri Behar Fazliu, është nderuar me çmimin "Kadeti më i mirë ndërkombëtar", pas një trajnimi gjashtëmujor në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore në Cranwell të Mbretërisë së Bashkuar. Çmimi "Kadeti më i mirë ndërkombëtar" për nëntoger Behar Fazliun, por edhe çmimet tjera të mëparshme janë dëshmi se FSK-ja është në rrugë të duhur sa i përket ngritjes profesionale të pjesëtarëve të saj, dhe se ky kualitet profesional është duke u dëshmuar edhe jashtë vendit, si në: shkollime, trajnime dhe operacione, në akademitë më prestigjioze.

Nëntogeri i FSK-së Rilind Idrizi merr çmimin "Studenti më i mirë ndërkombëtar" në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore të Mbretërisë së Bashkuar



Oficeri i FSK-së Rilind Idrizi shpërblehet me çmimin "Studenti më i mirë ndërkombëtar" në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore në Cranwell të Mbretërisë së Bashkuar në ceremoninë e mbajtur në diplomimin e kadetëve-oficerëve, që për 7 muaj vijuan studimet ushtarake në këtë kolegj. Nëntogeri Rilind Idrizi ka treguar performancë të jashtëzakonshme në fushën e studimeve ushtarake, akademike dhe praktike, dhe si rezultat i këtyre arritjeve ka marr çmimin e studentit më të mirë ndërkombëtar. Pjesë e këtij trajnimi ishte edhe tetar FetiPronaj. Në këtë ceremoni i pranishëm ishte edhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama i cili ndër të tjera pati thënë: "Suksesi i kadetëve dhe oficerëve tanë në akademitë më prestigjioze në botë, është edhe një dëshmi se FSK-ja po ndërtohet me standardet më të larta profesionale të nivelit të shteteve të NATO-s" .

Tetari i FSK-së Rafet Gashi fiton garën ndërkombëtare ,,Ushtari më i mirë i vitit 2017"

Në kazermën ,,Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), në ceremoninë e shpalljes së rezultateve të garës "Ushtari më i mirë i vitit 2017", çmimin e ushtarit më të mirë në garën ndërkombëtare e ka fituar tetari Rafet Gashi - pjesëtar i Batalionit të Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, vendin e dytë e zuri ushtaraku nga Kroacia, tetar IvoVasiq, ndërsa vendin e tretë e zuri ushtari Besnik Nebihu po ashtu pjesëtari i FSK-së - pjesëtar i Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së. Ndërsa në garën e FSK-së ,,Ushtari më i mirë i vitit 2017", vendi i parë i takoi tetarit BinakPodrimqaku, vendi i dytë tetarit ElvisHasanaj dhe vendi i tretë ushtarit Mehdi Bajraktari, që të gjithë pjesëtarë të Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama është shprehur se gara e FSK-së për ushtarin më të mirë të vitit tanimë është tradicionale dhe në vazhdimësi është një sfidë me të cilën pjesëtarët e FSK-së janë familjarizuar dhe nëpërmjet saj po tregojnë suksese



si brenda FSK-së ashtu edhe në gara ndërkombëtare. Më tej, komandanti i FSK-së shtoi: "Viti 2017 është viti kur FSK-ja ka krijuar mundësitë që një garë e tillë të jetë garë me pjesëmarrje edhe të ushtarakëve nga shtetet e ndryshme, gjë që për FSK-në do të thotë shumë. Këtë vit garën ,,Ushtari më i mirë" e bën edhe më të veçantë pjesëmarrja e ushtarëve nga 7 shtete partnere, duke e shndërruar kështu në garë ndërkombëtare ushtarake".
Përveç Kosovës pjesë e garës ndërkombëtare ishin edhe Shqipëria, Belgjika, Kanadaja, Kroacia, Maqedonia, Turqia dhe Britania e Madhe. Gara është zhvilluar në këto disiplina: test fizik, gjuajtje me armë, navigim tokësor, poligon me pengesa, hedhje e granatës, kalimi i zonës së rrezikshme, ndihmë e parë, vëzhgim i terrenit, marshim i shpejtë me ngarkesë dhe testi me shkrim i njohurive ushtarake
(testi me shkrim ishte vetëm për garuesit e FSK-së).

Kadeti e FSK-së Xhevahir Hasanaj merr medalje në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst



Nëntoger Xhevahir Hasanaj ka fituar medaljen "Kadeti më i mirë ndërkombëtar" në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst. Kryeministrja e Mbretërisë së Bashkuar zonja TheresaMay në emër të Lartmadhërisë së saj Mbretëreshës Elisabetë, ka ndarë medalje për nëntogerin XhavihirHasanaj si dhe certifikata për kadetët të cilët mbaruan studimet atje. Me rastin e dhënies së medaljes oficerit të FSK-së, kadetit me rezultatet më të larta nga të gjithë oficerët-kadetë ndërkombëtarë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka deklaruar se rezultati i shkëlqyer i oficerit të FSK-së ka rëndësi të veçantë jo vetëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës, por edhe për gjithë Kosovën. "Jam i privilegjuar që gjendem sot, këtu, në cilësinë e komandantit, për të nderuar këtë ngjarje madhështore të organizuar nga kjo Akademi me nam, e cila çdoherë po nxjerrë oficerë që po na bëjnë krenarë me rezultatet e tyre",- ka thënë gjeneral Rama. Në këtë ceremoni ka diplomuar edhe nëntogeri Arlind Bajrami. Ishte hera e dytë që një oficer kadet nga Kosova fiton çmim si kadeti më i mirë ndërkombëtar.

Toger Adison Gara fiton çmimin "Top Student" në Kursin për Instruktor të Operacioneve Shumëkombëshe të Mbështetjes së Paqes



Pjesëtari i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Batalioni i Tretë i Reagimit të Shpejtë, kapiten Adison Gara ka fituar çmimin "Top Student", në Kursin për Instruktor të Operacioneve Shumëkombëshe në Mbështetje të Paqes në Vyshkov të Republikës së Çekisë, në mesin e 30 studentëve, oficerë nga 8 shtete të botës. Trajnimi ka përfshirë aktivitete të ndryshme rreth përgatitjeve të instruktorëve për operacione paqeruajtëse. Ishte planifikuar dhe udhëhequr nga Ekipi Këshillues Ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar (BritishMilitaryAdvisoryTeam- (BMAT). Pjesëtarët e FSK-së, pjesëmarrës në këtë kurs, kanë treguar rezultate të larta si në aspektin akademik gjithashtu edhe në atë praktik gjatë zhvillimit të operacioneve. Pjesëmarrja e pjesëtarëve të FSK-së në Kursin e Instruktorëve të Operacioneve Shumëkombëshe në Mbështetje të Paqes (Multinational Peace Support Operations Instructor Training Course), është në vazhdën e bashkëpunimit dypalësh me Britaninë e Madhe. Qëllimi i kursit ishte pajisja e instruktorëve me njohuri teknike të nevojshme dhe përgatitja e tyre me aftësi konvencionale ushtarake. Përveç kapiten Adison Garës, këtë kurs e kanë vijuar edhe kapiten Alban Bujupi, toger Elbasan Sabedini dhe rreshter major Bedri Zuka.

Togeri Nysret Buzhala studenti më i mirë ndërkombëtar në Shkollën e Forcave Speciale "John Kennnedy" të SHBA-ve

Oficeri i FSK-së, togeri Nysret Buzhala, u shpall studenti më i mirë ndërkombëtar në trajnimin "Kapiten Karriere" që realizohet nga Shkolla e Forcave Speciale "John F. Kennnedy", të Ushtrisë së SHBA-ve, në periudhën kohore nëntor 2016 -nëntor 2017.

Pasi mori vlerësime të larta, gjithashtu arriti të jetë në Listën e Komandantit, duke u radhitur i pesti në këtë listë ku përfshiheshin të gjithë studentët përfshirë edhe ata të Ushtrisë amerikane. Toger Buzhala gjatë shkollimit ka treguar performancë të shkëlqyer në të gjitha fazat e shkollimit si: Analizat regjionale, kursin kualifikues për marrëdhënie civile, trajnimin "Kapiten Karriere" si dhe në ushtrimin përmbyllës "Ushtrimi kulmor" (Culmination Exercise), duke u renditur si njëri nga studentët me vlerësimet më të larta. Si rezultat i performancës së lartë, pas përfundimit të trajnimit, toger Nysret Buzhala u dekorua me medaljen e meritave, "Medalja e lavdërimit" (Commendation Medal).



Kursi i Avancuar për Lider realizon ushtrimin fushor "Evakuimi me Helikopter"



Më 14 qershor 2017, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes-Qendrën e Zhvillimit Profesional të Udhëheqësve në Ferizaj, në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit me Brigadën Shumëkombëshe të Lindjes (KFOR-i Amerikan në Kampin Bondsteel), bazuar në planin e stërvitjes, është mbajtur ushtrimi fushor: Kursi i Avancuar për Lider. Në këtë ushtrim janë realizuar me sukses temat, si: Procedurat e udhëheqjes së trupave, Evakuimi i viktimave me helikopter etj. Pjesa praktike e ushtrimit, Evakuimi i viktimave me helikopter, është realizuar falë bashkëpunimit dhe partneritetit me Kampin Bondsteel, të cilët dhanë mbështetje si në pjesën teorike, ashtu edhe në atë praktike, që ofruan edhe helikopterin për të demonstruar aftësitë e fituara nga pjesëtarët e FSK-së, gjatë ushtrimit. Pjesëtarët e Kursit të Avancuar për Lider, janë pajisur me njohuri se si duhet të barten viktimat me barela dhe viktimat të cilat kanë lëndime më të lehta. Pjesëtarët e ushtrisë amerikane, demonstruan: lëshimin individual me litar nga helikopteri; tërheqjen e viktimave nga lartësia-mbi 100 metra me litar. Të kënaqur me realizimin me sukses të këtij ushtrimi u shprehën rreshter majori i Kampit Bondsteel, JEFFREY SCHUSTER si dhe rreshter majori i KDS-së, Imri AZEMI, të cilët premtuan vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, në këtë fushë.

Në Brigadën për Reagim të Shpejtë realizohet me sukses gara sfiduese "UJKU GARUES 2017"



Në Brigadën për Reagim të Shpejtë në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, është realizuar gara "Ujku Garues 2017". Kjo garë është realizuar për herë të tretë në nivel të BRSH-së, ku garuesit sfidohen në shkathtësi profesionale dhe fizike. Në garë kanë marrë pjesë gjithsej 13 ekipe. Secili batalion i BRSH-së me nga 3 ekipe, gjithsej 9 ekipe, BMO me tri ekipe dhe KDS-ja me një ekip. Disiplinat në te cilat u sfiduan garuesit ishin: Vrapimi 3.2 km, hedhja e granatës së dorës, shtyrja e autoblindës, vëzhgimi, kalimi i zonave të minuara dhe kalimi mbi zona të rrezikshme. Synimi kryesor i organizimit të kësaj gare ka qenë që ekipet pjesëmarrëse të sfidoheshin në disiplinat e lartcekura, në mënyrë që të dëshmonin përgatitjen fizike dhe mendore. Kjo garë gjithashtu është realizuar me qëllim të motivimit të pjesëtarëve për ngritjen e vazhdueshme të shkathtësive profesionale dhe bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet njësive të FSK-së. Ceremonia e certifikimit të garës së shkathtësive ushtarake "Ujku Garues 2017" është realizuar në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog. Në ceremoni ishin të pranishëm: gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, KOMBRSH kolonel Xhevahir Geci, Zv.KOMBMO kolonel Avdi Raci, rreshter major komandues e Gardës se IOWA-s Reachel Fails, Shtabi i BRSH-së, komandantët e batalioneve, oficerë dhe nënoficerë të BRSH-së dhe njësive tjera të FSK-së. KOMBRSH, kolonel Geci në fjalën së tij drejtuar të pranishmëve ka shfrytëzuar rastin t'i uronte të gjitha ekipet për sukseset që treguan në këtë garë. Ai veç tjerash ka thënë : "Qëllimi ynë është që përmes kësaj gare të ngremë nivelin e punës ekipore, shpirtin garues dhe përgatitjen fizike dhe profesionale të pjesëtarëve të njësive tona. Planifikimi dhe organizimi profesional, vlerësimi transparent dhe rritja e interesimit për pjesëmarrje janë shenjat më të mira që gara "Ujku Garues" është duke evoluar dhe zhvilluar edhe më tej".

Në fund të garës, në bazë të performancës së treguar, në mënyrë transparente është bërë përzgjedhja e tri vendeve të para të cilat u vlerësuan me çmime si në vijim: - Vendi i Tretë- BRSH - Batalioni i Tretë K3A; - Vendi i Dytë – BRSH - Batalioni i Parë Ekipi i Tretë; Vendi i Parë – BRSH - Batalioni i Dytë K2B.

Tri vendet e para u shpërblyen, nga komandanti i BRSH-së, me Emblemën e BRSH-së. Të gjitha ekipet pjesëmarrëse u pajisën me certifikata, ndërsa rreshter majorja amerikane Reachel Fails u nderua me mirënjohje.



Fituesit e ushtrimit "Shqiponja Patrulluse-17"




Më 6.10.2017, në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcës Tokësore (KFT) të FSK-së, është mbajtur ceremonia e shpalljes së fituesve të garës së FSK-së, në ushtrimin "Shqiponja Patrulluse-17". Fituesit e garës të ushtrimit "Shqiponjat Patrulluese-17" janë: Komanda e Forcave Tokësore me ushtrues skuadre, nëntoger Arsim Dreshaj, e cila zuri vendin e parë. Në vendin e dytë u rendit, Batalioni i Dytë i BRSH-së, me udhëheqës skuadre, nëntoger Gentrit Idrizi, kurse vendin e tretë e zuri Batalioni i Tretë, me udhëheqës skuadre, nëntoger Drilon Hasani.

Në ceremoninë e certifikimit kanë marrë pjesë: ministri i FSK-së, zotëri Rrustem Berisha, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, përfaqësues të NALT-it, (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, për FSK-në), Mark Theobald, komandantët e njësive të FSK-së, si dhe oficerë të tjerë të FSK-së.

Ministri Rrustem Berisha, pasi ka përgëzuar ushtarët dhe stafin udhëheqës të FSK-së, për realizimin e ushtrimit; Shqiponja patrulluese 17, pos tjerash ka deklaruar: "Është me rëndësi që brenda FSK-së, të vazhdojmë të kemi një frymë garuese, me qellim të ngritjes të sukseseve tona, drejtë realizimit të misionit që kemi". Ministri Berisha në fund ka përgëzuar të gjithë pjesëtarët e FSK-së duke thënë: "Prandaj, ju përgëzoj për sukseset që keni arritur. Urojë që në të ardhmen në organizime të tilla garuese të marrin pjesë edhe shtete e rajonit". Zëvendëskomandanti i KFT-së, gjenerali Gëzim Hazrolli për këto arritje ka falënderuar instruktorët britanikë dhe ata të Kanadasë. "Falënderoj instruktorët nga Britania dhe Kanadaja si për planifikimin ashtu edhe organizimin e garës. Po ashtu dua të falënderoj të gjithë oficerët dhe pjesëtarët që kanë kontribuar në realizimin me sukses të kësaj gare. Po ndihem krenar me nivelin e moralit dhe angazhimit tuaj, në realizimin e detyrave. Urime dhe suksese tjera", e ka përmbyllur fjalën e tij gjeneral Hazrolli.

Stërvitjet përgatitore për ushtrimin garues "Shqiponja fluturuese 17" janë zhvilluar në çdo njësi madhore të FSK-së, për gjashtë muaj. Ndërsa për garën finale janë kualifikuar tetë skuadra me nga 72 pjesëtarë, të cilët kanë vazhduar aktivitetet ditën dhe natën, deri sa kanë përfunduar skenarin e ushtrimit, kur edhe u shpallën fituesit e garës. Zëvendëskomandanti KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ekipit trajnues nga Britania e Madhe dhe Kanadaja u dha Mirënjohje, për mbështetjen profesionale të FSK-së, në garën "Shqiponja Patrulluese 17". Ushtrimi "Shqiponja Patrulluese 17" për herë të parë është planifikuar dhe realizuar nga pjesëtarët e FSK-së, dhe është modeli më i avancuar i ushtrimeve të këtij lloji. Kjo garë këtë vit është organizuar për herë të parë nga oficerët dhe nënoficerët e FSK-së, sipas modelit të ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe është paraparë të jetë garë tradicionale vjetore, ku do të ftohen edhe ushtarakë të ushtrive të shteteve tjera të rajonit.



Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, KFOR-i, FSK-ja dhe Policia e Kosovës realizojnë ushtrimin e përbashkët "MASCAL-2017"



Në Aeroportin e Gjakovës, është realizuar ushtrimi fushor "MASCAL-2017" nën udhëheqjen e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME), në mbështetje të KFOR-it, dhe në bashkëpunim me njësitë e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), Policisë së Kosovës (PK), Zjarrfikësve të Gjakovës, Rahovecit, Malishevës si dhe Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF)në Gjakovë.

Për ta përcjellë nga afër ushtrimin që demonstruan këto institucione të pranishëm ishin edhe zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zv. komandant i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Rainer, drejtori i përgjithshëm i AME-së, z. Fadil Kodra si dhe eprorë të FSK-së, KFOR-it dhe Policisë së Kosovës.

Të pranishmëve me një fjalë rasti ju është drejtuar gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i cili ka thënë: "Dua t'i falënderoj të gjithë aktorët pjesëmarrës! Është një madhështi kur shohim një bashkëpunim dhe kapacitete të institucioneve të ndryshme të reagimit në incidente të përbashkëta. Jam shumë i sigurt që me këtë ushtrim kemi avancuar edhe në bashkëpunimin dhe koordinimi e përbashkët në intervenim në incidente të skenarëve të tillë, por pa diskutim që është një mundësi e jashtëzakonshme të nxjerrim mësime dhe të punojmë në ngritjen e kapaciteteve aty ku sot, kemi vërejtur që kemi nevojë të punojmë më tepër".

Forca e Sigurisë, Policia e Kosovës dhe KFOR-i realizua ushtrimin e përbashkët "Shpata e argjendtë 2017-1"

Në kazermën "Evropianët e Rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Bardh të Vogël dhe në Kampin "Vrellë" në Sllatinë u zhvilluan operacionet e ushtrimit fushor "Shpata e argjendtë 2017-1(Silver Sabre'17), i cili u realizua nën udhëheqjen e KFOR-it në bashkëpunim me njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Policisë së Kosovës (PK) dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (EMA).



Për ta përcjellë nga afër ushtrimin, që demonstruan këto institucione, të pranishëm ishin edhe drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral brigade Zymer Halimi, zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Enver Cikaqi, ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delaëie, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Rainer, si dhe eprorë te FSK-së, KFOR-it dhe Policisë së Kosovës.

Me një fjalë rasti të pranishmëve u është drejtuar gjeneral Hazrolli, i cili ka thënë se me këtë ushtrim po testohen kapacitetet operacionale dhe bashkëpunimi mes KFOR-it, FSK-së dhe Policisë së Kosovës. "Falënderoj KFOR-in për mundësinë që na ka ofruar që institucionet e Kosovës, e sidomos FSK-ja të stërvitet për të treten herë më radhë, së bashku me njësitë operacionale të KFOR-it, të cilat veprojnë në Kosovë. "Shpata e argjendtë" është një ushtrim në të cilin janë testuar kapacitetet operacionale, si dhe koordinimi dhe bashkëpunimi me të gjitha institucionet dhe autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë siç janë KFOR-i, FSK-ja, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhim të Emergjencave".

Institucionet dhe agjencitë e Kosovës për menaxhimin e krizave realizojnë ushtrim të përbashkët



Në kazermën "Evropianët e Rinj" në Pomozotin, është mbajtur ushtrimi fushor i institucioneve dhe agjencive të Kosovës për menaxhimin e krizave, në raste të incidenteve me tren. Në këtë ushtrim ishin të përfshira njësitet e këtyre institucioneve dhe agjencive: Ambasada Amerikane, KFOR-i Amerikan, Forca e Sigurisë së Kosovës, Agjencia për Menaxhim të Krizave, Policia e Kosovës, Hekurudhat e Kosovës, tri brigada të zjarrfikësve (Prishtinës, Drenasit dhe Llapnasellës), Kryqi i Kuq i Kosovës, dega në Fushë Kosovë dhe stafi nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë. Për ta përcjellë nga afër këtë ushtrim ishin të pranishëm edhe zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zv. komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO), kolonel Avdi Raci, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), kolonel Shaip Haziri, udhëheqësi i ekipit për mbështetje nga Ambasada Amerikane, kapiten Peter Preisinger, zv. kryeshefi i Trainkos-it, Naim Neziri, drejtori i Departamentit të Operimeve në Trainkos, drejtori i Departamentit të Gatishmërisë në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, Hajriz Sejdiu, drejtori i Departamentit të Parandalimit në Agjencinë e Emergjencave, Alush Beqiri etj.

Komandanti i FSK-së viziton në terren pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit



Kompania e Deminimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, që nga muaji prill e deri më tani, çdo ditë pastrojnë zona të minuara nëpër territore të ndryshme të Republikës së Kosovës. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me kolonelët Naim Hazirin, Avdi Racin dhe Shaip Hazirin, kanë vizituar deminerët gjatë punës së tyre në "Parkun e Lirisë" në Ferizaj dhe në "Han të Elezit" për t'u njohur nga afër me angazhimin dhe vështirësitë e mundshme që mund t'ju dalin gjatë punës së tyre. Gjeneralin Rrahman Rama, lidhur me punën e pjesëtarëve të kësaj kompanie në terren, e ka njoftuar komandanti i Kompanisë së Deminimit, kapiteni Sejdi Krasniqi. Komandanti i FSK-së i ka përgëzuar deminerët për punën e tyre të palodhshme dhe profesionale, si dhe për suksesin që ata janë duke treguar në pastrimin e zonave të minuara.

FSK-ja u mban ligjërata nxënësve për rrezikun nga mjetet shpërthyese



Kompania e Deminimit e FSK-së po e shfrytëzon sezonin dimëror, për mbajtjen e ligjëratave për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve shpërthyese, siç janë: minat, bombat, bombat kasetë etj. Më 17 janar 2017 instruktorët e Deminimit kanë mbajtur ligjërata në komunën e Parteshit për nxënësit e komunitetit serb.

Ky aktivitet është organizuar nga Departamenti për BCU i MFSK-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Parteshit. Instruktorët e FSK-së ligjëratat për vetëdijesimin e nxënësve i kanë mbajtur në shkollën "Miladin Popoviq" në Pasjan dhe në shkollën "Dosidej Obradoviq" në Partesh. Interesimi i nxënësve për t'u pajisur me informacione ishte i mirë.





FSK-ja dhe KFOR-i demoluan mjete të pashpërthyera në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Deminimit



Në Poligonin e KFOR-it, në Zatriq të Rahovecit, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Deminimit, është organizuar një operacion për deminimin -shkatërrimin e mjeteve të pashpërthyera, i cili është realizuar nga FSK-ja, KFOR-i, Policia e Kosovës dhe nga disa organizata joqeveritare.

Në shënimin e kësaj dite ishin të pranishëm zëvendësministri i FSK-së, z. Muhamet Latifi, gjeneral brigade Zymer Halimi, Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve, zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, z. Ahmet Sallova, shef i Qendrës Koordinuese të Deminimit, si dhe përfaqësues të KFOR-it, Policisë së Kosovës, KFOR-i amerikan - Bonstill dhe organizatat joqeveritare që veprojnë në Kosovë. Pas prezantimit të pajisjeve dhe aktivitetit të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, KFOR-it, Policisë së Kosovës si dhe të organizatave joqeveritare, është mbajtur edhe një takim i shkurtër me përfaqësues të mediave.

Me këtë rast, zëvendësministri i MFSK-së, z. Muhamet Latifi ka thënë: "Kemi ardhur këtu për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Deminimit dhe për të përcjellë nga afër përgatitjen profesionale dhe kapacitetet operacionale të pjesëtarëve të FSK-së". Duke e vlerësuar si shumë të rëndësishëm pastrimin e zonave të minuara, Ministria i ka kushtuar rëndësi të madhe aftësimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët po japin kontribut të shkëlqyeshëm në këtë aspekt. Këtu ka ndodhur një luftë e cila ka lënë pasoja shumë të mëdha, ku janë minuar shumë fusha. Pastrimi i këtyre fushave është shumë më rëndësi për ne, sepse përveç se siguron jetën e qytetarëve dhe lëvizjen e lirë të tyre, ndikon edhe në zhvillimin ekonomik, për arsye se shumë prona deri më tani nuk kanë pasur mundësi të shfrytëzohen nga qytetarët".

Shefi i Qendrës Koordinuese të Ministrisë së FSK-së, z. Ahmet Sallova ka pasqyruar aktivitetet e përgjithshme të Kompanisë së Deminimit të FSK-së. Ai ka shtuar se FSK-ja që nga viti 2010 ka pastruar mbi 1.745,465 metra katrorë sipërfaqe të minuar dhe ka shkatërruar 2177 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera, kurse ekipet e EOD-së kanë intervenuar në 2136 raste dhe kanë demoluar 3150 mjete të ndryshme eksplozive. Në fund z. Sallova ka thënë se përkundër kësaj pune të madhe të njësive të deminimit deri më tash, janë ende edhe 111 zona të prekura nga minat dhe mjetet tjera eksplozive të pashpërthyera.



FSK-ja në punëtorinë për pastrimin e bombave kasetore në Sarajevë



Në Sarajevë (Bosnje dhe Hercegovinë) nga data 08 deri më 10 nëntor 2017, është mbajtur punëtoria për pastrimin e bombave kasetore, për vendet e Ballkanit Perëndimor, organizuar nga Norvegjia dhe Holanda, si bashkë-koordinatore të edukimit për reduktimin e krizës dhe zvogëlimit të rrezikut sipas Konventës për bombat kasetore. Në këtë punëtori ka marrë pjesë drejtori i Qendrës Koordinuese për Deminim z. Ahmet Sallova dhe nënkoloneli Rifat Sylejmani, shef i Sektorit për Plane dhe Operacione në Ministrinë për FSK-në. Në punëtori janë diskutuar edhe temat: problemet e kontaminimit nga bombat kasetore të mbetura pas luftës, si dhe koha e resurset e nevojshme për pastrimin e tyre. Z. Ahmet Sallova në emër të MFSK-së, ka prezantuar raportin për situatën e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ai ka theksuar faktin se Kosova është vendi më i kontaminuar me bomba kasetore në Evropë, dhe njëherësh ka kërkuar përkrahjen nga donatorët potencialë për të siguruar një progres të vazhdueshëm në pastrimin e zonave të prekura nga bombat kasetore në Kosovë.

Task-Forca e Kërkim-Shpëtimit të FSK-së



Aktivitetet e Task-Forcës së Kërkim Shpëtimit- Ka marrë pjesë në ushtrimin fushor "Shpata e Argjendtë"; ka mbështetur njësitë e FSK në ushtrimet fushore (Batalionet e BRSH); ka marrë pjesë në marshime dhe gara të ndryshme të organizuar nga FSK-ja, KFOR-i dhe OJQ-të, ku kanë arritur rezultate të jashtëzakonshme.

Të arriturat dhe sukseset- Përmbushja e kapaciteteve të plota të kompanisë së Task-Forcës së Kërkim Shpëtimit; kryerja e shumë trajnimeve profesionale dhe të avancuara brenda vendit, kryerja e trajnimit të avancuar për paramedikë në QKUK; kryerja e trajnimit për "Kërkim Shpëtim" në Kroaci; zhvillimi i trajnimeve për K9 në Turqi; Pjesëmarrja në garat sportive ku ka treguar rezultate të larta.

Operacionet- Njësia e KSH ka marrë pjesë në intervenimet reale në gjithë vendin si:
në fshatin Mramorë të komunës së Prishtinës për kërkimin e një fëmije të humbur; në komunën e Gjakovës (ura e fshejtë) për kërkimin dhe nxjerrjen nga lumi të një viktime;
në komunën e Mitrovicës për shuarjen e zjarrit në shkollën "Musa Hoti"; në fshatin Kçiç për shuarjen e zjarrit malorë; në Ranilluk ka intervenuar për kërkimin e një personi të humbur.

Përmbyllet me sukses ushtrimi fushor "Veprimi i Shpejtë 10"



Në kazermën " Evropianët e Rinj" në Regjimentin e Mbrojtjes Civile dhe në hapësirat e Termocentralit ,,Kosova A" është mbajtur ushtrimi fushor ,,Veprimi i Shpejtë 10", i cili është realizuar nga pjesëtarët e Kompanisë 3 C të Batalionit të Tretë. Ushtrimi ka filluar që nga data 10.01.2017në kuadër të Gjenerimit të Forcës për fazën e parë të vitit 2017, ku pjesëmarrës ishin edhe institucionet tjera të sigurisë nga regjioni i Obiliqit si: Kuvendi Komunal i Obiliqit, Policia e Kosovës, AME-ja, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financave, Qendra e Klinikës Mjekësore Familjare, Kryqi i Kuq, Brigada e Zjarrfikëseve të KEK-ut. Me rastin e përfundimit të këtij ushtrimi për të pranishmit është mbajtur një takim i shkurtër, ku janë njoftuar me mbarëvajtjen e këtij ushtrimi, rolin dhe rëndësinë e tij. Të pranishmëve me një fjalë rasti iu është drejtuar edhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i cili ka vlerësuar lart procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor ,,Veprimi i Shpejtë 10", si dhe koordinimin ndërmjet agjencive civile dhe BAT i 3-të i BRSH-së. Ai ndër të tjera ka thënë: "I falënderoj të gjithë të pranishmit të cilët kanë marrë pjesë në këtë ushtrim. Është një mundësi e jashtëzakonshme dhe një rast i veçantë që të fillojmë t'i identifikojmë kapacitet, por edhe zbrazëtirat tona në zhvillimin e operacioneve të tilla të menaxhimit të fatkeqësive të ndryshme. Si FSK në kuadër të misionit që kemi jemi gjithmonë të gatshëm të zhvillojmë operacione të tilla, sepse në këtë mënyrë zhvillojmë edhe kapacitetet tona. Po ashtu misioni i këtyre ushtrimeve është që të zhvillojmë edhe ndërveprueshmërinë me institucionet tjera të sigurisë në vend. Prandaj skenarë të tillë organizohen me qëllim që nesër të jemi të gatshëm të ndërveprojmë në raste të jashtëzakonshme si në tërmete, vërshime dhe situata tjera, me qëllim që të përgatitemi dhe stërvitemi, në kohë paqeje, për menaxhimin e incidenteve, në mënyrë që nesër të jemi të gatshëm që secili të kryejë punën e tij, bazuar në Planin e Reagimit Kombëtar".



Në ditën përfundimtare të këtij ushtrimi janë ekzekutuar gjithsej shtatë operacione të ndryshme si: menaxhimi i turmave, zjarri në lokacione urbane, aksidente komunikacioni, trajtime mjekësore, kërkim-shpëtim me litar, zona e kontaminuar, operacione urbane, si dhe mbështetjen e KFOR-it në tërheqjen me helikopter të të lënduarve. Ky ushtrim zhvillohet në kuadër të planit vjetor të trajnimeve dhe aktiviteteve të Batalionit të Tretë, qëllimi i të cilit është mbajtja e nivelit të gatishmërisë së pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe bashkëpunimi me agjencitë tjera në zonën e përgjegjësisë së Batalionit të Tretë.

Aktivitetet të shumta të MKAB-së



Operacionet e zhvilluara reale nga MKAB-ja - Operacioni në SHMF "Asim Vokshi" Prishtinë – janar 2017; operacioni i transportit të izotopeve radiologjike në "Kompleksin Trepça" në Mitrovicë; operacioni në QO BMO (matja e rrezatimit) – maj 2017; Jemi në përgatitje e sipër për ri ambalazhimin e materieve kimike në „EURO STILL", Pejë të rreth 200 fuçive si dhe transportimin e tyre në një depo më të sigurt e që pritet të realizohen brenda këtij viti.

Inspektimet e planifikuara të zhvilluara - Në tërë territorin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2016 janë zhvilluar 34 operacione inspektimi me nga 5 pjesëtarë, me ç 'rast janë dhënë rekomandimet e duhura për mbajtjen nën kontroll të materieve të rrezikshme. Ndërsa gjatë vitit 2017 deri më tani janë realizuar 31 operacione të inspektimeve në të gjithë territorin e Kosovës.

Ushtrimet fushore të vitit 2017- Ushtrimi fushor „Shpata e Argjendtë"; ushtrimi fushor në mbështetje të BRSH-së; ushtrim me AME-në në Pomozotin; ushtrim me AME-në në Gjakovë etj.

FSK-ja dhuron vullnetarisht qindra doza gjak

Në Ministrinë për FSK-në dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës, brenda vitit, gjatë muajve janar-shkurt dhe qershor-korrik, janë organizuar aksione humanitare për dhurimin vullnetar të gjakut për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Edhe gjatë këtij viti Departamenti për Bashkëpunim Civilo–Ushtarak, bazuar në planin e veprimit për vitin 2017, në bashkëpunim me Departamentin Mjekësor në MFSK dhe Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, kanë organizuar aksionin për dhurimin vullnetar të gjakut nga pjesëtarët e MFSK-së dhe FSK-së. Aksioni për dhurimin vullnetar të gjakut gjatë vitit 2017 është realizuar në Ministri dhe në të gjitha njësitë dhe kazermat e FSK-së, sipas një plani të dizajnuar paraprakisht. Pjesëtarët e FSK-së, si gjithnjë edhe kësaj here kanë treguar gatishmëri për t'iu dalë në ndihmë



qytetarëve të Republikës së Kosovës. Drejtori i DBCU-së, Hajrush Kurtaj me këtë rast ka thënë: "Ne të gjithë po ndjehemi krenarë që me gjakun tonë të dhuruar vullnetarisht po arrijmë të shpëtojmë jetë njerëzish pa dallime". Ndërkaq, menaxheri për marketing në QKTGJK-së, zoti Fadil Mahmuti, ka vlerësuar lart interesimin e madh të pjesëtarëve të FSK-së dhe stafit civil të MFSK-së, në përgjigje të këtij aksioni. Drejtori i Departamentit të Mjekësisë në MFSK, dr. Xhevdet Tahiraj, është shprehur: "Që ditën e parë, këtij aksioni i janë përgjigjur një numër i madh i pjesëtarë të MFSK-së dhe FSK-së, të cilët tashmë e kanë bërë traditë organizimin e aksionit humanitar për dhurimin e gjakut, me moton: një pikë gjak për shpëtimin e një jete".

Forca e Sigurisë së Kosovës realizon vizita mjekësore për komunitetet



Njësia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza (NJNRK) e FSK-së së bashku me Kompaninë e Mjekësisë, përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-ve, Zyrën e Elementit Mbështetës Civilo-Ushtarak si dhe përfaqësuesit e drejtorive për mirëqenie sociale të komunave Ferizaj dhe Lipjan, më 4 tetor 2017, kanë kryer vizita mjekësore tek personat e moshuar të komuniteti serb. Vizitat janë realizuar në Lipjan dhe në fshatrat Bablak dhe Pleshinë, nga mjekët e FSK-së në bashkëpunim me mjekët e qendrave të Mjekësisë Familjare në Ferizaj dhe Lipjan dhe Zyrës së Elementit Mbështesë Civilo-Ushtarak (ZEMCU-së). Vlen të ceket se ky projekt është pritur jashtëzakonisht mirë nga të moshuarit e komunitetit serb të cilëve iu është ofrua ndihma, gjë të cilën e dëshmon edhe znj. Gospogjinka Millovanoviq nga fshati Bablak, e cila është shprehur mjaft e kënaqur dhe falënderuese për kujdesin dhe ndihmën që i është dhënë. Projekti humanitar në ndihmë të komuniteteve që jetojnë në Kosovë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Personeli mjekësor i Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare në ushtrimin e përbashkët me ekipin e mjekëve të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar



Në ndërtim të partneritetit gjashtëvjeçar, ushtarët dhe pjesëtarët e Forcës Ajrore nga Garda Kombëtare e Ajovës, së bashku me pjesëtarët e Kompanisë Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK) kanë marrë pjesë në kursin dhe ushtrimin fushor mjekësor shumëdimensional dyjavor në Qendrën Trajnuese Mbështetëse(QTM) në kampin Dodge Joint Maneuver Training Center (CDJMTC), si pjesë e Programit për Partnership Shtetëror (PPSh). PPSh lidh SHBA-të me vendet partnere në tërë botën për të promovuar qasjen, rrit kapacitetet, përmirëson ndërveprueshmërinë dhe rritë parimet e përgjegjësisë qeverisëse. Gjatë ushtrimit fushor "Shqiponja V" në Prizren, Kosovë, personeli mjekësor nga FSK-ja, së bashku me pesë pjesëtarë të MEDHAWKS, nga grupi mjekësor i Batalionit 132, ju kanë bashkuar Batalionit mjekësor shumëdimensional të përberë nga ushtarët e Kompanisë Mjekësore 134(ambulancë tokësore), Kompania Mjekësore 209 dhe 294 (mbështetja në terren) për periudhën e tyre të trajnimit kolektiv në QTM. Gjatë këtij trajnimi pjesëtarët patën mundësi të trajnohen prej simulantëve trajnues në Qendrën mjekësore - ku ata fituan dhe demonstruan aftësi jetike të shpëtimit të jetës në luftë, të kryejnë dhe perfeksionojnë detyrat individuale mjekësore në ambiente të trajtimit mjekësor si dhe të marrin pjesë dhe të rriten si liderë gjatë trajnimit dhe seminarit të personelit të sektorëve në procesin e vendimmarrjes ushtarake.


Aktivitete të Batalioni të Xhenios gjatë vitit 2017



Batalioni i Xhenios gjatë vitit 2017, brenda misionit ka arritur të planifikojë, organizojë dhe realizojë shumë trajnime brenda dhe jashtë vendit, me qëllim ngritjen profesionale të pjesëtarëve, pjesëmarrjen në ushtrime dhe gara të ndryshme si dhe operacione/projekte xheniere brenda dhe jashtë FSK-së. Vlen të theksohet se me angazhimin e Batalionit të Xhenios është përmbushur jo vetëm misioni i batalionit dhe ai i Brigadës së Mbështetjes Operacionale, por është përmbushur edhe vetë misioni i FSK-së. Angazhimi i batalionit në kuadër të projekteve humanitare jashtë FSK-së ka qenë i suksesshëm, duke ndihmuar qytetarët e vendit pa dallim bindje partiake apo besimi fetar.

Gjatë këtij viti janë realizuar 11 projekteve humanitare xheniere në ndihmë qytetarëve të Kosovës në territore të ndryshme të vendit. Mund të veçohen: hapja e rrugëve nga bora në 7 fshatra malore të Komunës së Artanës (Llabjan, Vllasali, Bunjak, Kllubar, Tullar, Izbor dhe Makresh i ulët); hapja e rrugës nga bora në fshatra dhe tek antenat e FSK-së në Jezerc – Budakovë (Budakovë –Antenat Ferizaj dhe Therandë); hapja e rrugëve dhe parkingjeve nga bora tek varrezat e dëshmorëve Zahir Pajaziti dhe Hakif Zejnullahu - Orllan, Turiqicë dhe Lladofc – Besianë; rrafshimi i oborrit të SHFMU „Hasan Prishtina" në Busovatë – Dardanë; rrafshimi i parkingut të KF „2 Korriku' 'Prishtinë; rregullimi i rrugës me gjatësi 1 km, Pasjan – Partesh; hapja dhe mbyllja e një kanali në fshatin Shushicë – Graqanicë; rregullimi i fushës sportive për ekipin „Përparimi" në Runik – Skenderaj; vendosja e rafteve në bibliotekën e fshatit Restelicë – Dragash.

FSK institucioni më i besueshëm në Republikën e Kosovës



"Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave KIPRED", ka bërë shpalosjen para mediave të rezultateve të matjeve të opinionit publik kosovar për periudhën 15 nëntor 2016 deri me 15 shkurt 2017, për institucionet e sigurisë në vend dhe për drejtuesit kryesorë të këtyre institucioneve. Sipas rezultateve të prezantuara edhe këtë radhë, për herë të pestë, rezulton se FSK-ja është vlerësuar si institucioni më i besueshëm i sigurisë në Kosovë, me shkallën më të lartë 3.74. Kurse në vlerësimin e drejtuesve të institucioneve të sigurisë, ministri i MFSK-së, zoti Haki Demolli, është vlerësuar me shkallën më të lartë 2.88. Sipas publikimit, besueshmërinë më të lartë, sipas rajoneve Forca e Sigurisë së Kosovës e ka te qytetarët shqiptarë të veriut të vendit, përderisa ka ndryshime të shifrave në përqindje në rajonet tjera, që gjithashtu besueshmëria për FSK-në është e lartë. Këto vlerësime janë pasqyrim i rezultateve të punës së palodhshme dhe të përkushtuar të të gjithë pjesëtarëve të FSK-së. Ky rezultat është edhe tregues i menaxhimit dhe drejtimit me shumë transparencë të MFSK-së dhe FSK-së, në kryerjen e detyrave që dalin nga misioni aktual që kanë. Sigurisht se këto vlerësimet të larta i obligojnë edhe më shumë FSK-në dhe MFSK-në, që edhe në të ardhmen të angazhohen edhe më tepër në realizimin e objektivave të planifikuar dhe kryerjen e detyrave të përgjithshme, që dalin nga Plani i Veprimit Vjetor të Punës.

FSK-ja institucioni i parë me Plan për Integritet



Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka prezantuar raportin e tretë monitorues dhe vlerësues me temën: Monitorimi dhe vlerësimi i integritetit në institucionet e sigurisë, që në fokus ishin dy institucionet më të besueshme të Kosovës: Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës.

Në këtë prezantim kanë marrë pjesë: Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Shkëlzen Sylaj, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtor i Departamentit të Operativës dhe Trajnimeve, sekretari i sekretarit të përgjithshëm të MFSK-së, z. Florin Hoxha, përfaqësues të Policisë së Kosovës, të OJQ-ve si dhe monitorues dhe përfaqësues të mediave. Me këtë rast është thënë se Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka për qëllim vlerësimin dhe monitorimin e aktiviteteve që lidhen me zhvillimet në fushën e integritetit në institucionin e FSK-së dhe MFSK-së dhe Policinë e Kosovës. Ky raport mbulon periudhën monitoruese tetor 2016 - tetor 2017 dhe është vazhdimësi e raporteve tjera të QKSS-së, në funksion të ngritjes së integritetit në sektorin e sigurisë.

Në prezantimin e raportit nga znj. Arife Muji për FSK-në është thënë se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK-ja) aktualisht është një ndër institucionet e vetme të sigurisë në rajon që posedon Plan të Integritetit. Është pioniere në hartimin e Planit të Integritetit në nivel qendror, sepse deri në shtator të vitit 2017 Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka vazhduar të jetë institucioni i vetëm që ka arritur të hartojë dhe zbatojë një plan të tillë. MFSK-ja vazhdon zbatimin e këtij plani i cili në vetvete ngërthen masa dhe veprime në funksion të fuqizimit të integritetit.

Raporti i prezantuar është fokusuar kryesisht në pesë fusha kyçe: prokurimi publik, menaxhimi i burimeve njerëzore, auditimi i brendshëm, parandalimi i konfliktit të interesit si dhe deklarimi i pasurisë. Përmes vlerësimit të këtyre fushave, ky raport ka bërë vlerësimin dhe identifikimin e sfidave dhe progresit të këtij institucioni, si dhe ka sjellë rekomandime specifike në këto fusha. Besueshmëria, qeverisja e brendshme dhe integriteti janë parimet kryesore të cilat garantojnë funksionalizim të qëndrueshëm dhe kredibil të institucioneve të sigurisë në Kosovë.

Diplomuan kadetët e FSK-së, gjenerata 2017

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së, në Ferizaj, kanë diplomuar kadetët e Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, gjenerata 2017.

Në fjalën e tij, ministri i FSK-së, z. Haki Demolli, diplomimin dhe gradimin e kadetëve të FSK-së, e ka cilësuar si një ditë të veçantë për të dhe FSK-në. "Diplomimi dhe gradimi i kadetëve është një shembull i mirë i zhvillimit dhe i ngritjes profesionale të FSK-së, përmes investimit në dije dhe në shkencë. Kjo është dëshmia më e mirë, se ne po e krijojmë një forcë profesionale, konform standardeve më të larta ushtarake, pra sipas kritereve dhe standardeve të NATO-s".



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij ka theksuar: "Nga ju pres që të jeni udhëheqës të ndershëm, të guximshëm dhe të punoni me përkushtim. Gjithashtu, pres nga ju, që të gjitha vështirësitë me të cilat do të ballafaqoheni në të ardhmen, t'i ktheni në mundësi, se vetëm kështu ne do të zhvillojmë dhe avancojmë institucionin tonë që të jetë i gatshëm të përmbushë misionin e vet, t'u dalë në ndihmë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të kontribuojë në sigurinë rajonale e globale".

Pas gradimit të kadetëve në gradën e nëntogerit, ministri Demolli, komandant Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral Enver Cikaqi dhe majori Avni Kiqina u kanë ndarë certifikatat oficerëve të rijnë të FSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama i ka dorëzuar kadetit, Vilson Musajt, çmimin "Kadeti më i mirë i gjeneratës 2017".

Rekrutët (kadetët) e rinj të FSK-së betohen për shërbim ndaj Atdheut



Në kazermën „Adem Jashari" në Prishtinë, më 29.09.2017, solemnisht kanë dhënë betimin, 16 rekrutë të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)- "Gjenerata 2021", të cilët filluan shkollimin për kadetë në Qendrën për Studime Universitare(QSU).

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama para kadetëve të rinjë ka thënë: „Gjatë katër viteve të ardhshme ju do të edukoheni, zhvilloheni dhe trajnoheni si udhëheqës, por në asnjë mënyrë mos bëni kompromis me detyrën, nderin dhe atdheun. Respektimi i vlerave dhe standardeve do t'ju bëjë persona më të mirë në ushtri, në familje dhe në shoqëri".

Ndërsa, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, ju ka drejtuar kadetëve të sapo betuar me këto fjalë: "Betimi që bëtë sot, iu obligon me përgjegjësi të reja të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë në jetën tuaj, në familjet tuaja dhe në raport me FSK-në".

Në fund rekrutët, kadetët e vitit të parë të studimeve, para oficerëve, familjarëve dhe mysafirëve të tjerë dhanë betimin dhe nënshkruan kontratën e shërbimit në FSK. Këtë vit janë pranuar dhe kanë filluar vitin akademik 16 rekrutë të rinj, dy prej tyre janë nga Republika e Shqipërisë. Kjo gjeneratë pritet të përfundojë studimet në vitin 2021.

Diplomojnë rekrutët e FSK-së nga radhët e komuniteteve jo-shumicë

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj, është mbajtur ceremonia e diplomimit të 61 rekrutëve të FSK-së, nga radhët e komunitetit jo-shumicë, pas kryerjes së kursit bazik, "Gjenerata e parë 2017".

Në ceremoninë e diplomimit të rekrutëve kanë marrë pjesë: Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK) z. Haki Demolli, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK-së) gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, z. Greg Delawie, oficerë, nënoficerë dhe familjarë të rekrutëve dhe të ftuar të tjerë. Presidenti i Kosovës, z. Hashim Thaçi, njëherësh edhe Komandant Suprem i FSK-së, i ka përgëzuar rekrutët e rinj të FSK-së nga radhët e komuniteteve jo- shumicë për zgjedhjen që ata kanë bërë për t'i shërbyer vendit si ushtarë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. „Në përputhje me rekomandimet e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë dhe në koordinim të plotë me partnerët tanë strategjikë po punojmë për ta përfunduar transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të





Kosovës". Ndërsa, ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli, me rastin e diplomimit të rekrutëve, veç tjerash pati theksuar: "Po theksoj se certifikimi i sotëm e ka të veçantën e vet, sepse përmes tij, jo vetëm që po bëhet plotësimi i kapaciteteve njerëzore të strukturës së FSK-së, por po bëhet edhe përmbushja e numrit të pjesëtarëve të FSK-së nga radhët e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë, duke pasqyruar në mënyrë të kënaqshme diversitetin etnik të qytetarëve të shtetit tonë". Në fund, është zhvillua ceremonia e ndarjes së certifikatave, ku rekrutët bënë Betimin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Gradimi i pjesëtarëve të FSK-së nga radhët e komuniteteve jo shumicë



Në kazermën "New Born" të FSK-së në Gjilan, me 13.11.2017, u mbajt ceremonia e gradimit të pesë pjesëtarëve të FSK-së, nga radhët e komuniteteve jo shumicë. Në ceremoni të pranishëm ishin presidenti i Kosovës, z. Hashim Thaçi, ministri i FSK-së, z. Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralët: Gëzim Hazrolli, Enver Cikaqi, gjenerali Ralf Hoffmann, drejtori i NALT-it, komandanti i BRSH-së, koloneli Xhevahir Geci, atasheu i Mbrojtjes i SHBA-ve, majori Juan Murillo si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Në fjalën e tij presidenti i Kosovës, z. Hashim Thaçi, uroi FSK-në për ndërtimin e një force profesionale, gjithë-përfshirëse dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës. "Sot shënojmë gradimin e pesë pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Të gjithë vijnë nga komunitetet jo shumicë, duke e shtuar kështu prezencën e tyre në FSK dhe duke kontribuar në realizimin e aspiratës që kemi për forcën tonë të sigurisë. Pasi kanë kaluar trajnimet dhe testet e parapara, këta pesë pjesëtarë të FSK-së nga sot do të mbajnë gradën e nënoficerit të FKS-së. Trajnimet dhe testet nëpër të cilat kalon çdo pjesëtar i FSK-së janë të përgatitura nga NATO-ja sipas standardeve të saj".

Rrustem Berisha, në fjalën e tij, tha: "Ceremonia e sotme më gëzon shumë sepse dëshmon se FSK-ja është bërë forcë e besueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, forcë shumetnike, e hapur për të gjithë dhe në shërbim të të gjithëve". Ndërsa duke ju drejtuar pjesëtarëve të graduar, ministri Berisha, shtoi se: "Kjo dëshmon se ju si qytetar të shtetit të Kosovës, keni bërë zgjedhjen e duhur kur jeni përcaktuar për të shërbyer në FSK, si strukturë e gjithë qytetarëve pa dallime etnike, race apo gjinie". Presidenti i vendit, z. Hashim Thaçi, ministri Berisha, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, koloneli Xhevahir Geci dhe zëvendësdrejtori i NALT-it, gjenerali Ralf Hoffmann, graduan nënoficerët: Marjan Paunovic, Lubisha Demic, Milosh Periç, Gyner Xhymshiti dhe Xhezair Hasani.





FSK-ja ndihmon QMF të fshatit Plemetin me materiale mjekësore



Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), ka realizuar një projekt humanitar duke dhuruar materiale të nevojshme mjekësore për Qendrën e Mjekësisë Familjare të fshatit Plemetin të komunës së Obiliqit, e cila kujdeset dhe ofron shërbime mjekësore për banorët e shumë fshatrave të banuara me serbë, romë, ashkali dhe të tjerë.


FSK-ja jep donacion për qytetarët e komunitetit jo shumicë në Graqanicë

FSK-ja më 4 janar 2017 i ka dhuruar një donacion humanitar (batanije, jastëkë dhe mbulesa) Kishës Ortodokse Serbe në Graqanicë. Kjo ndihmë i dedikohet qytetarëve të komunitetit jo shumicë të këtij vendbanimi. Dorëzimi është bërë në ambientet e Manastirit në Graqanicë nga nënkoloneli Afrim Veseli, shef i Sektorit për Bashkëpunim me Agjencitë në kuadër të Departamentit për Marrëdhënie Civilo-Ushtarake në Ministrinë për FSK-në, ndërsa pranimi është bërë nga prifti Sergjan Stankoviq, zyrtar i Manastirit. Prifti Stankoviq, me këtë rast, ka falënderuar FSK-në, ambasadën e SHBA-ve si dhe KFOR-in amerikan, për ndihmën e ofruar për qytetarët e Graqanicës. "Kjo ndihmë është e mirëpritur në këto kushte të vështira atmosferike dhe ekonomike. Prandaj, falënderoj ambasadën e SHBA-ve, KFOR-in amerikan dhe



Forcën e Sigurisë së Kosovës", ka thënë veç tjerash prifti Stankoviq. Ndërsa, nënkoloneli Veseli, ka thënë se FSK-ja deri më tani ka zbatuar shumë projekte humanitare në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim feje dhe kombi. Ai premtoi se FSK-ja edhe në të ardhmen, do të jetë pranë qytetarëve të Kosovës, në realizimin e projekteve, qofshin ato humanitare apo projekte tjera që janë në shërbim të qytetarëve. Gjithashtu nënkolonel Veseli ka falënderuar ambasadën e SHBA-ve, në Prishtinë, dhe KFOR-in amerikan, për përkrahjen e vazhdueshme për FSK-në.

FSK-ja i dhuron një karrige stomatologjike Komunës së Artanës



Ministria për FSK-në në kuadër të aktiviteteve të saj, rëndësi të posaçme i kushton realizimit të projekteve të ndryshme humanitare në dobi të të gjithë qytetarëve të Kosovës. FSK-ja i ka dhuruar një karrige stomatologjike Komunës së Artanës, dedikuar fshatit Llabjan. Në ceremoni të pranishëm ishin: kryetari i Komunës, zyrtarë të Drejtorisë së Shëndetësisë, stafi mjekësor i ambulancës së fshatit Llabjan, zyrtarë të lartë të FSK-së, atasheu i Mbrojtjes së SHBA-ve, major Murillo. Ky donacion i Qendrës Klinike Stomatologjike të Kosovës kishte për qëllim lehtësimin e nevojave të qytetarëve të Artanës, për t'iu mundësuar atyre realizimin e disa shërbimeve stomatologjike në ambulancën e fshatit. Në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës, nënkoloneli Afrim Veseli ka theksuar se MFSK-ja është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe komuniteteve pa dallim. Ai ka premtuar se edhe në të ardhmen FSK-ja do t'i ndihmojë qytetarët e vendit pa dallime përkatësie etnike, gjuhësore apo fetare. Ndërsa kryetari Svetisllav Ivanoviq, në emër të gjithë qytetarëve të komunës ka falënderuar FSK-në për ndihmën e ofruar duke thënë se: "Karriga stomatologjike, për ne ka qenë prioritet, si pajisje mjaft e rëndësishme në shërbim të gjithë qytetarëve të kësaj ane, sidomos në shërbim të fëmijëve dhe nxënësve".

KFOR-i dhe FSK-ja ndihmojnë shkollën fillore në Sushicë të Graqanicës



KFOR-i në bashkëpunimi me Departamentin për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të Ministrisë për FSK-në, (CIMIC), janë angazhuar në rregullimin e rrjetit të kanalizimit në shkollën e fshatit Sushicë të Komunës së Graqanicës, fshat i banuar me popullsi shqiptare dhe serbe. Kërkesa është identifikuar nga CIMIC-u, KFOR-i dhe më pas është vlerësuar nga DBCU e MFSK-së. Ndërsa, Batalioni i Xhenios i FSK-së, më 12 korrik 2017, është angazhuar në realizimin e projektit për hapjen dhe mbylljen e kanalit në gjatësi prej 30 m. Tubacioni i prishur i kanalizimit ka shkaktuar një ambient jo të shëndoshë dhe të rrezikshëm për fëmijët e këtij lokaliteti, që nga janari i këtij viti. Prandaj JRDC, përmes Ekipit slloven Ndërlidhës të Monitorimit, FSK-së dhe Komunës së Graqanicës ka blerë gypin dhe ka siguruar ekipin teknik për instalim. Aktivitetet e FSK-së, janë në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe etnive, në mënyrë të paanshme dhe me respektin më të thellë për kulturat e ndryshme dhe besimet fetare.

Orkestra e Ushtrisë turke dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës zhvilluan koncert të përbashkët



Në kazermën „Adem Jashari" në Prishtinë është mbajtur një koncert i përbashkët i Orkestrës Muzikore të Forcave të Armatosura të Turqisë dhe Orkestrës të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në koncert të pranishëm ishin stafi i lartë i FSK-së dhe ai i Ushtrisë së Turqisë. Gjenerali Gëzim Hazrolli, zv. komandant i KFT-së, ka falënderuar për këtë iniciativë dhe për bashkëpunim me Ushtrinë Turke. „Shkëmbimi i eksperiencave me Orkestrën Muzikore të Ushtrisë Turke dhe atë të FSK-së, do të jetë edhe një e arritur e pa diskutueshme që do të shohim në të ardhmen". I kënaqur nga realizimi i këtij bashkëpunimi është shprehur edhe komandanti i Kontingjentit ushtarak turk në Kosovë, kolonel Mustafa Tavazar " Bendi Muzikor i Ushtrisë së Turqisë së bashku me Orkestrën Frymore të FSK-së na bënë që të përjetojmë qaste të këndshme. Jemi mjaft të kënaqur edhe me bendin që ka FSK-ja". Gjatë këtij koncerti të pranishmit patën mundësi që të argëtohen dhe të shijojnë interpretimin e veprave të mrekullueshme nga të dyja orkestrat, me ç 'rast Orkestra turke ka befasuar publikun me interpretimin e dy këngëve shqipe të cilat u priten mjaft mirë nga të gjithë të pranishmit.

Pjesëtarë të FSK-së licencohen për instruktorë të arteve marciale



Më 10 shkurt 2017 në ambientet e kazermës "Adem Jashari" në Prishtinë janë certifikuar 10 pjesëtarë, pas trajnimit fizik për instruktorë në lëmin e arteve marciale. Trajnimi është realizuar nga një ekip mobil i instruktorëve të Marinës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Zv. komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, me këtë rast ka thënë:" Ky trajnim është një vlerë e re, një aftësi e re dhe një mundësi e re. Në kontekst të kësaj dua t'ju siguroj që do t'i përdorim këto vlera dhe aftësi të reja, duke i futur si kurs në plan - programin e zhvillimit të nënoficerëve, dhe pa diskutim se kjo do të shërbejë si një mundësi e mirë për aftësimin e secilit pjesëtar të FSK-së". Gjeneral Hazrolli ka falënderuar Ambasadën e SHBA-ve, për mbështetjen e dhënë në fushën e arteve marciale.

Granit Kryeziu zuri vendin e parë në garën e organizuar nga KFOR-i



Më 20 shkurt 2017, në Fshatin e Ri (Novosellë), Komuna e Vushtrrisë, nën patronatin e komandantit të KFOR-it, gjeneral majorit Giovanni Fungo, është mbajtur vrapimi humanitar në shtegun 5 mijë metra. Përveç përfaqësuesve të KFOR-it morën pjesë edhe 7 pjesëtarë të FSK-së. Hapjen zyrtare e ka bërë komandanti i KFOR-it, gjenerali Fungo, i cili ka falënderuar pjesëtarët e FSK-së për pjesëmarrjen e tyre në këtë vrapim humanitar. Në një konkurrencë të fortë, vendin e parë e zuri Granit Kryeziu, pjesëtar i BRSH-së të FSK-së, i cili u nderuar me medaljen e artë, personalisht nga komandanti i KFOR-it, gjenerali Giovanni Fungo. Granit Kryeziu me këtë rast tha: "Vendi i parë dhe medalja e artë janë sukses jo vetëm i imi, por në përgjithësi sukses edhe i FSK-së, me çka po dëshmohet çdo ditë e më tepër se pjesëtarët e FSK-së janë të përgatitur sipas standardeve të NATO-s". Qëllimi i organizimit të kësaj gare ishte tërësisht me karakter humanitar, ku të gjitha mjetet e grumbulluara do t'ju shpërndahen familjeve në nevojë.

Zhvillohet ndeshje futbolli në mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Maqedonisë



Në Sallën e sporteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës është zhvillua ndeshje miqësore në futboll të vogël (Futsall) në mes ekipit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë. Takimin e përbashkët e kanë përshëndetur ministri i FSK-së, z. Rrustem Berisha dhe gjenerali Gëzim Hazrolli, të cilët njëherësh kanë falënderuar delegacionin ushtarak nga Maqedonia për bashkëpunimin e përgjithshëm në të gjitha fushat dhe në të gjitha sportet, duke theksuar se ky bashkëpunim do të vazhdojë të zhvillohet edhe më shumë në të ardhmen në mes FSK-së dhe FARM-së. Topin nga qendra në formë simbolike e nisën ministri Berisha dhe atasheu ushtarak i Republikës së Maqedonisë në Kosovë, koloneli Donce Kuzmanov. Të dy ekipet zhvilluan një ndeshje atraktive me aksione të organizuara mirë. Ndeshja është përcjellë nga qindra shikues. Ekipi i FSK-së, pati epërsi si në pjesën e parë ashtu edhe në të dytën, duke u dalluar për një nuancë, falë kombinimeve të shkurtra gjatë lojës dhe konkretizimin e rasteve me gola. Ekipi i FSK-së ka fituar me rezultatin 6:2. Gjithë takimi është zhvilluar në suazat e lojës së fer-plejit. Në fund zv. komandanti i KFT-së, gjenerali Gëzim Hazrolli dhe atasheu ushtarak i Republikës së Maqedonisë, koloneli Kuzmanov u kanë ndarë kupa dhe mirënjohje të dyja ekipeve me motivacion për: "disiplinë dhe rezultate të treguara gjatë ndeshjes ndërkombëtare miqësore në futsal në mes të ekipeve përfaqësuese të Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Getoar Rexhepi fitoi titullin e Kampionit Kombëtar Shqiptar në Karate



Togeri i FSK-së, Getoar Rexhepi ka marrë çmimin e parë në Kampionatin e 24-të të Karatesë të mbajtur, më 12 nëntor 2017, në Tiranë, ku kanë marrë pjesë 14 ekipe nga Republika e Shqipërisë. Togeri Rexhepi është i sistemuar në Batalionin e Tretë të BRSH-së në Mitrovicë. Ai gjatë karrierës së tij ka arritur suksese të lakmueshme në sportin e karatesë si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Gjatë karrierës së tij Getoari ka fituar shumë tituj kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke arritur kështu të fitojë dhjetë herë titullin e Kampionit të Kosovës, dy herë titullin e Kampionit Mbarëkombëtar Shqiptar (2014 dhe 2017), si dhe shumë kupa e medalje të arta nëpër turne ndërkombëtare. Mirëpo, çmimi i fundit ka një rëndësi mjaft të madhe për Getoarin. Për këtë ai është shprehur: "Karateja si sport dhe traditë ka luajtur një rol shumë pozitiv në formimin tim profesional dhe në zhvillimin dhe përsosjen e karakterit tim. Titulli i Kampionit Kombëtar të Shqipërisë për vitin 2017, për mua është një nder i veçantë dhe shpresoj që arritjet e mia të jenë shembull për gjeneratat e reja".

Ushtari Granit Kryeziu zuri vendin e parë në "Dita e Vrapimit CISM 2017"





Më 17 shkurt 2017, 10 pjesëtarë të FSK-së kanë marrë pjesë në aktivitetin sportiv "Dita e Vrapimit CISM 2017", të organizuar nga FA të Republikës së Shqipërisë, që ka përkuar me ditën e festimit të përvjetorit të 9-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Ky aktivitet është zhvilluar në ambientet e Forcave Tokësore në Zall-Herr në dy disiplina; 5 kilometra për meshkuj dhe 3 kilometra për femra, dhe është përcjellë me interesim edhe nga drejtuesit e lartë të FARSH-it. Në konkurrencën e meshkujve, ushtari i FSK-së Granit Kryeziu nga Brigada e Reagimit të Shpejtë, ka zënë vendin e parë dhe është shpërblyer me kupë, ndërsa në konkurrencën e femrave, në shtegun prej 3 kilometrash, vendin e dytë e ka zënë tetar Mimoza Morina nga KDS-ja.

Realizohet gara humanitare ,,Vrapo me FSK-në Mitrovica 2017”



FSK-ja në bashkëpunim me Federatën e Atletikës së Kosovës dhe Komunën e Mitrovicës, më 3 mars 2017, kanë organizuar në Mitrovicë garën “Vrapo me FSK-në Mitrovica 2017” Për ta përcjellë nga afër ceremoninë ishin të pranishëm gjenerali Zymer Halimi, nënkryetari i Mitrovicës Faruk Mujka si dhe shumë eprorë dhe oficerë të FSK-së. Në vrapimin e gjatë 10 km, kanë marrë pjesë pjesëtarë të FSK-së, të KFOR-it, të shoqërive joqeveritare, qytetarë të Kosovës, si dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O’Connell së bashku me bashkëshorten e tij. Të gjithë garuesit kanë përfunduar me sukses këtë vrapim. Tri vendet e para i kanë zënë: Emin Grajqevci, Tiron Mamusha dhe Bujar Uka, ndërsa në kategorinë e femrave të parat u renditën: Qëndresa Ramadani, Nebahate Maqasterna dhe Manushaqe Nura. Vrapimi humanitar “Vrapo me FSK-në” është një aktivitet i iniciuar dhe organizuar nga oficerët e rinj të FSK-së, me qëllim të promovimit të shëndetit të mirë përmes aktivitetit sportiv, por mbi të gjitha ka vlera humane, sepse mjetet e fituara u janë dhuruar familjeve në nevojë.





PËRMBAJTJA

Përkushtim, punë dhe profesionalizëm i lartë në FSK....3
Vit i zhvillimit profesional dhe integrimit të plotë të komuniteteve jo-shumicë....4
Emërimi i zotit Rrustem Berisha ministër i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës....5
Kryeministrit Ramush Haradinaj viziton Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës....5
Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës viziton Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë....6
Ministri Rrustem Berisha në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifaks të Kanadasë....7
Ministri Rrustem Berisha priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralin Giovanni Fungo....8
Ministri Haki Demolli ka pasur takim me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jans Stoltenberg....8
Komandanti i FSK-së dhe drejtori i NALT-it raportuan në Komitetin
për Operacione dhe Politika të NATO-s në Bruksel....9
Ministri Demolli ka pritur zëvendës-ndihmësin e Sekretarit Amerikan të Shtetit për
çështje evropiane dhe euro-aziatike, Hoyt Brian Yee....9
Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama në Departamentin e Mbrojtjes dhe në
Kongresin e SHBA-ve....10
Komandanti i FSK-së ka pritur Komandantin Suprem të Forcave Aleate për Evropë....10
Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur shefin e Komandës Amerikane për
Operacione Speciale në Evropë, gjenerallejtënant Mark Schwartz....11
Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama në Asociacionin e Ushtrisë së SHBA-ve....11
Gjenerallejtënant Rrahman Rama në Konferencën e Partneritetit Ndërshtetëror me Gardat Kombëtare të SHBA-ve...12
Komandanti i FSK-së dhe Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës vizitojnë njësitë e FSK-së....12
Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në Konferencën "SHBA-Karta e Adriatikut A-5"....13
Gjenerallejtënant Rrahman Rama ka vizituar Forcat e Armatosura të Turqisë....14
Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë vizitë zyrtare në FSK....14
Ministria e FSK-së ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë....15
Sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj në Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë....15
Drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane z. Faruk Geci në takimin e shefave për
politika dhe plane SHBA-Karta e Adriatikut....16
Konferenca "FSK dhe Partnerët - 2017"....16
I. Konferenca e 6-të ,,FSK dhe Partnerët''....16
II. Konferenca e 7-të ,,FSK dhe Partnerët''....17
FSK-ja përkujton 11 shtatorin e sulmeve terroriste në SHBA....18
Ministri dhe komandanti i FSK-së kanë nderuar sakrificën e ushtarakëve britanikë të rënë në Kosovë....18
FSK shenoi 19 - vjetorin e Epopesë së UÇK-së....19
Ministri Demoli dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama bënë homazhe në Koshare....20
FSK nderon të rënët në Reçak....20
Mministri Demolli dhe komandant Rama bënë homazhe në Gllogjan....21
FSK-ja përfundon stërvitjen shumëkombëshe ,,KFOR 23'' në Gjermani....21
Pjesëtarë të FSK-së përfundojnë me sukses trajnimin për kërkim-shpëtim në Republikën e Kroacisë....22
Pjesëtarë të FSK-së certifikohen Instruktorë të Trajnimit Fizik në Britani të Madhe....22
Behar Fazliu shpallet kadeti më i mirë ndërkombëtar në Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore....22
Nëntogeri i FSK-së Rilind Idrizi merr çmimin "Studenti më i mirë ndërkombëtar" në
Kolegjin Mbretëror të Forcave Ajrore të Mbretërisë së Bashkuar....23

Tetari i FSK-së Rafet Gashi fiton garën ndërkombëtare ,,Ushtari më i mirë i vitit 2017''.....23
Kadeti e FSK-së Xhevahir Hasanaj merr medalje në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst.....24
Toger Adison Gara fiton çmimin "Top Student" në Kursin për Instruktor të Operacioneve Shumëkombëshe të Mbështetjes së Paqes.....24
Togeri Nysret Buzhala studenti më i mirë ndërkombëtar në Shkollën e Forcave Speciale "John Kennnedy" të SHBA-ve.....25
Kursi i Avancuar për Lider realizon ushtrimin fushor "Evakuimi me Helikopter".....25
Në Brigadën për Reagim të Shpejtë realizohet me sukses gara sfiduese "UJKU GARUES 2017".....26
Fituesit e ushtrimit "Shqiponja Patrulluse-17".....27
Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, KFOR-i, FSK-ja dhe Policia e Kosovës realizojnë ushtrimin e përbashkët "MASCAL-2017".....28
Forca e Sigurisë, Policia e Kosovës dhe KFOR-i realizua ushtrimin e përbashkët "Shpata e argjendtë 2017-1".....28
Institucionet dhe agjencitë e Kosovës për menaxhimin e krizave realizojnë ushtrim të përbashkët.....29
Komandanti i FSK-së viziton në terren pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit.....29
FSK-ja u mban ligjërata nxënësve për rrezikun nga mjetet shpërthyese.....30
FSK-ja dhe KFOR-i demoluan mjete të pashpërthyera në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Deminimit.....31
FSK-ja në punëtorinë për pastrimin e bombave kasetore në Sarajevë.....32
Task-Forca e Kërkim-Shpëtimit të FSK-së.....32
Përmbyllet me sukses ushtrimi fushor "Veprimi i Shpejtë 10".....33
Aktivitetet të shumta të MKAB-së.....34
FSK-ja dhuron vullnetarisht qindra doza gjak.....34
Forca e Sigurisë së Kosovës realizon vizita mjekësore për komunitetet.....35
Personeli mjekësor i Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare në ushtrimin e përbashkët me ekipin e mjekëve të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar.....35
Aktivitete të Batalioni të Xhenios gjatë vitit 2017.....36
FSK institucioni më i besueshëm në Republikën e Kosovës.....36
FSK-ja institucioni i parë me Plan për Integritet.....37
Diplomuan kadetët e FSK-së, gjenerata 2017.....37
Rekrutët (kadetët) e rinj të FSK-së betohen për shërbim ndaj Atdheut.....38
Diplomojnë rekrutët e FSK-së nga radhët e komuniteteve jo-shumicë.....38
Gradimi i pjesëtarëve të FSK-së nga radhët e komuniteteve jo shumicë.....39
FSK-ja ndihmon QMF të fshatit Plemetin me materiale mjekësore.....40
FSK-ja jep donacion për qytetarët e komunitetit jo shumicë në Graqanicë.....40
FSK-ja i dhuron një karrige stomatologjike Komunës së Artanës.....41
KFOR-i dhe FSK-ja ndihmojnë shkollën fillore në Sushicë të Graqanicës.....41
Orkestra e Ushtrisë turke dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës zhvilluan koncert të përbashkët.....42
Pjesëtarë të FSK-së licencohen për instruktorë të arteve marciale.....42
Granit Kryeziu zuri vendin e parë në garën e organizuar nga KFOR-i.....43
Zhvillohet ndeshje futbolli në mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Maqedonisë.....43
Getoar Rexhepi fitoi titullin e Kampionit Kombëtar Shqiptar në Karate.....44
Ushtari Granit Kryeziu zuri vendin e parë në "Dita e Vrapimit CISM 2017".....44
Realizohet gara humanitare ,,Vrapo me FSK-në Mitrovica 2017".....45

www.mksf-ks.org

FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 64 • Janar 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

Presidenti Hashim Thaçi mbajti fjalim para ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dje (6 dhjetor 2017) mbajti fjalim para ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve në kazermën ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore në Prishtinë.Në këtë takim presidentin Thaçi e shoqëronin komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralët: ZymerHalimi, Nazmi Brahimaj, Gëzim Hazrolli, Enver Cikaqi, si dhe stafi i lartë i FSK-së.Presidenti Thaçi fillimisht përshëndeti dhe njëherësh përgëzoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së, për arritjet e përgjithshme gjatë vitit 2017, si në aspektin individual dhe atë kolektiv, duke renditur sidomos sukseset e kadetëve tanë në akademitë më prestigjioze në botë, për të cilat tha se ndjehej krenar dhe i privilegjuar që ishte para tyre dhe i cilësoi si krenaria e Republikës së Kosovës.



Ai, para pjesëtarëve të FSK-së, foli edhe për transformimin e FSK-së, me ç'rast tha se Kosova do ta ketë ushtrinë moderne e cila do të themelohet në koordinim të plotë me NATO-n dhe partnerët e saj, duke vazhduar më tej: "Ashtu siç jeni sot, ju do të jeni forcë shumetnike, profesionale, mbrojtëse, që do të përfaqësoni me krenari shtetin tonë. Kosova duhet të ketë kapacitet të plotë mbrojtës dhe një ushtri moderne, që do t'i kontribuojë paqes dhe stabilitetit në rajon dhe kudo në botë. Ju pjesëtarë të FSK-së po e dëshmoni çdo herë veten duke shkëlqyer në secilin ushtrim apo garë ku po merrni pjesë. Ju po shkëlqeni në akademi ushtarake të njohura në botë. Uniforma që ju bartni, është ëndrra e stërgjyshërve tuaj, e kthyer në realitet. Ju jeni profesionistë dhe keni shumë për t'iu dhënë misioneve të ndryshme paqeruajtëse. Por, para së gjithash, ju e meritoni shansin e realizimit të potencialit të tuaj, duke u bërë së shpejti pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Kosovës. Ju me punën tuaj keni arritur t'i bëni krenarë prindërit tuaj, fëmijët tuaj, por mbi gjithçka, ju jeni krenaria e Republikës së Kosovës. Ne duhet reflektojmë së bashku për të arriturat e deritashme. Cilësia e demokracisë sonë nuk duhet të varet vetëm nga një sprovë e përfaqësuesve politikë me qytetarin vetëm përmes zgjedhjeve. Unë besoj se demokracia ndërtohet dhe forcohet nga shkëmbimi i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë i ideve dhe përvojave tona", tha presidenti Thaçi. Presidenti Thaçi tha në fjalën e tij ritheksoi se qëllimi ynë mbetet i qartë, të ndërtojmë një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të saj, dhe se shteti ynë duhet të jetë i integruar në familjen e kombeve botërore.

Në përfundim të fjalës së tij, presidenti Thaçi, tha:" detyrë e imja, detyra e juaja, detyrë e të gjithë neve, është që të punojmë pa u ndalur për të mirën tonë të përgjithshme. Uroj që të na prijë e mbara në realizimin e qëllimeve tona të mira në shërbim të qytetarëve dhe shtetit tonë".

Ministri Berisha kërkoi anëtarësimin e plotë të Kosovës në iniciativën „SHBA-Karta e Adriatikut-A5"

Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Rrustem Berisha, gjatë punimeve të Konferencës "SHBA-Karta e Adriatikut-A-5", (04.12.2017) që po mbahet në Ohër të Republikës së Maqedonisë, u paraqit me një ekspoze për zhvillimet aktuale në FSK-së dhe planet për të ardhmen e MFSK/FSK-së -si dhe zhvilloi takime dypalëshe me ministrat e Mbrojtjes të Malit të Zi, Maqedonisë, Bullgarisë dhe Republikës së Kroacisë.

Me këtë rast, ministri Berisha, para ministrave të Mbrojtjes të vendeve pjesëmarrëse në konferencë foli për zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së, pjesëmarrjen e njësive dhe pjesëtarëve të saj në shkollime, trajnime, ushtrime ndërkombëtare dhe për rezultatet e arritura si ato kolektive dhe individuale.Gjithashtu, ministri Berisha theksoi edhe rëndësinë që ka për FSK-në dhe Kosovën partneriteti me Gardën Kombëtare të Ajova-s të SHBA-ve, pastaj marrëdhëniet dypalëshe me shumë prej shteteve të NATO-s dhe të rajonit, si shkëmbimet dhe ndërveprimet e vazhdueshme me partnerët strategjikë dhe shumë shtete tjera.Ministri Berisha u fokusua edhe tek çështja e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura."Qasja jonë si Ministri, por edhe si Qeveri e Republikës së Kosovës është që pjesë e procesit të transformimit të FSK-së të jenë edhe komunitetet jo-shumicë që jetojnë në Kosovë, e në veçanti komuniteti serb, pasi kjo e lehtëson procesin e ndryshimeve kushtetuese dhe gjithashtu e përshpejton atë'', -tha ai.Në fund të fjalës së tij, ministri Berisha, theksoi kërkesën e Republikës së Kosovës për anëtarësim me të drejta të plota në kuadër të iniciativës "SHBA-Karta e Adriatikut-A5", si dhe në iniciative tjera rajonale.

"Po punojmë drejt përfshirjes në të gjitha iniciativat rajonale; duke përfshirë këtu edhe anëtarësimin e plotë në iniciativën e



Kartës së Adriatikut-A5, anëtarësimin në RACVIAC, bashkëpunimin e zgjeruar me NATO-n, e deri në anëtarësimin e plotë në strukturat euro-atlantike, që është edhe synim strategjik i Republikës së Kosovës'', tha ministri Berisha.

Komandanti i FSK-së priti me ceremoni ushtarake shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në vizitë zyrtare me ceremoni ushtarake shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.Në fillim të agjendës së tyre, komandantët patën një takim kokë më kokë.Më pas gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, u prit nga ministri i MFSK-sëRrustem Berisha.Gjatë takimit të dyja palët vlerësuan lart bashkëpunimin e deritashëm në mes dy forcave, duke e konsideruar këtë bashkëpunim si mjaft të dobishëm sidomos në shkëmbim të eksperiencave.Ministri Berisha e njoftoi gjeneral Kollçakun me të arriturat e FSK-së, procesin e përgatitjeve për transformim të saj në Forca të Armatosura (FAK), integrimin e komuniteteve pakicë në radhët e FSK-së, trajnimet, edukimin, stërvitjet si dhe objektivat strategjikë të MFSK-së dhe FSK-së.Krahas kësaj, u fol edhe për hapat nëpër të cilët ka kaluar FSK-ja që nga formimi i saj, duke përfshirë edhe Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë, objektivat për të ardhmen, transformimin, si dhe për fushat dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit edhe për vitin e ardhshëm.Më pas të dy gjeneralët dhanë nga një deklaratë për media. ***(vijon në faqen 4)***

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha u prit nga ministri i Mbrojtjes të Turqisë Nurettin Canikli



Në Ankara, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha u prit nga ministri i Turqisë, Nurettin Canikli me të cilin biseduan për marrëdhëniet e mira bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë në fushën e sigurisë dhe u theksua gatishmëria e dy ministrive për vazhdimin dhe intensifikimin e këtyre marrëdhënieve edhe në të ardhmen.

Me këtë rast, ministri Berisha ka falënderuar ministrin Canikli dhe nëpërmjet tij edhe popullin e Turqisë për mbështetjen e pakursyer për Kosovën dhe në veçanti për FSK-në në ngritjen, zhvillimin, profesionalizimin si dhe modernizimin e saj.

Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes së Republikës së Turqisë shprehu vullnetin e Ministrisë që ai drejton, që marrëdhëniet ndërmjet dy forcave, dy ministrive dhe dy vendeve të avancohen dhe intensifikohen në të ardhmen, duke u zotuar se do ta mbështesin FSK-në në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e saj si force moderne.

Gjatë qëndrimit në Ankara, ministri Berisha ka takuar edhe shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Turqisë, gjeneral HulusiAkar, nga i cili ka kërkuar që bashkëpunimin ushtarak ta vazhdojnë me partneritet të ngushtë.Ministri Berisha dhe delegacioni i FSK-së ka takuar edhe kadetët e FSK-së të cilët janë duke vazhduar shkollimin dhe trajnimet e tyre në Turqi, me përkrahjen e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Turqisë.

Ministri Berisha priti kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Kadri Veselin

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK) Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës të Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, sot (21 dhjetor 2017) në ambientet e MFSK-së pritën në vizitë pune kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. KadriVeseli. Ministri Berisha dhe gjeneral Rama e njoftuan z. Veseli me të arriturat e FSK-së, procesin e transformimit të saj në Forca të Armatosura (FAK), integrimin e komuniteteve pakicë në radhët e FSK-së, trajnimet si dhe objektivat strategjikë të MFSK-së dhe FSK-së.

Më pas, në një takim me mediat lidhur me këtë vizitë, ministri Berisha u shpreh: "Sot në Ministri, unë si ministër dhe komandanti i FSK-së, patëm për vizitë pune kryetarin e Kuvendit të Parlamentit të Kosovës KadriVeselin. Gjatë vizitës e njoftuam z. Veseli me të arriturat e FSK-së, me procesin transformimit të Forcës së Sigurisë në Forca të Armatosura të Kosovës, si dhe me objektivat strategjikë që si Ministri dhe Forcë ia kemi venë vetes për vitin 2018. Kryetari i Kuvendit Kadri Veseli tha se FSK-ja është institucioni me reputacionin më të lartë në Republikën e Kosovës, falë pjesëtarëve të saj.

Ai falënderoi ministrin dhe gjeneralin për punën e tyre profesionale dhe përmes tyre falënderoi pjesëtarët e FSK-së, duke u premtuar mbështetjen e vazhdueshme për fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të FSK-në edhe në të ardhmen. "Ne do ta vazhdojmë përkrahjen për FSK-në. Parlamenti është i gatshëm të merr çdo vendim i cili është në interes të sovranitetit dhe të fuqizimit të shtetit tonë.Kjo është ajo që do bëjmë edhe në të ardhmen. Në koordinim të plotë me partnerët tanë perëndimorë, NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), do ta kemi edhe vendimmarrjen për transformim të FSK-së. Ushtarakët e FSK-së kanë treguar suksese të veçanta në çdo pjesëmarrje. Ata janë dëshmuar edhe



në gara ndërkombëtare, duke u shquar me sukses dhe seriozitet. FSK-ja është partner i sigurt i NATO-s dhe e ardhmja e saj do jetë në NATO, - përfundoi kryetari Veseli.

Ministri dhe komandanti i FSK-së e pritën komandantin e KFOR-it





Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sot (11.12.2017) pritën në takime të ndara komandantin e KFOR-it, gjeneral major SalvatoreCuoci.Ministri Berisha dhe gjeneral Rama, gjatë takimeve që zhvilluan me gjeneralin Cuoci, folën për bashkëpunimin e mirë dhe të ngushtë të MFSK/FSK-së me KFOR-in, si dhe u zotuan për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Ministri Berisha, komandantit të KFOR-it, i shprehu dëshirën e tij dhe të Ministrisë që ai drejton, për të rritur bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve në dobi të sigurisë në vend dhe në të mirë të gjithë qytetarëve.

Krahas kësaj, ministri Berisha foli edhe për kapacitetet operacionale të FSK-së, duke shprehur gatishmërinë e FSK që me disa nga kapacitetet e saj të kontribuojë për paqe në rajon dhe më gjerë. Po ashtu, foli për suksesin e arritur të FSK-së për sa i përket integrimit të komuniteteve në radhët e saj, në veçanti të komunitetit serb. Më tej, ministri Berisha shpalosi idenë e planit të transformimit të FSK-së, i cili proces parashihet të ndodhë me ndryshime kushtetuese, me konsensus të plotë të faktorit të brendshëm dhe në koordinim me NATO-n dhe partnerët strategjikë të Kosovës.Ndërsa, komandanti i KFOR-it, gjeneral major SalvatoreCuoci përgëzoi udhëheqësit e FSK-së për rezultatet e arritura deri më tani dhe shprehu përkrahje të parezervë dhe zgjerim të fushave të bashkëpunimit në të ardhmen.

Gjenerali Cuoci, në fund tha se KFOR-i do të vazhdojë të jetë këtu për aq sa do të ketë nevojë, ndërsa sa i përket transformimit të FSK-së, ritheksoi rekomandimin e NATO-s, se Kosova duhet të vendosë vet si një vend sovran mbi të ardhmen e Forcës së saj, dhe këtë duhet ta bëjë në harmoni me Kushtetutën dhe përfshirjen e të gjithëve në proces.

Gjeneral Rama merr letër urimi nga gjenerali amerikan Joseph Dunfort

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pranuar një letër urimi për Ditën e Forcës nga Kryetari i Shefave të Shtabit të Ushtrisë Amerikane, gjenerali i Trupave Detare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneral Joseph F. Dunfort i Riu.

Gjenerali Dunfort, në letër i shpreh Komandantit të FSK-së dhe të gjithë pjesëtarëve, urimet më të mira dhe të sinqerta me rastin e Ditë së Forcës duke u shprehur: ,, Urime për ju dhe për pjesëtarët e FSK-së për festimin e Ditës së FSK-së''.

Gjenerali Dunfort, më tej në letrën e tij thekson se ,,Ushtria amerikane çmon partneritetin me FSK-në, dhe udhëheqja juaj shërben si një shenjë udhëzuese për shoqërinë kosovare''.Gjenerali amerikan, duke iu drejtuar Komandantit të FSK-së, gjeneral Ramës thekson në letër se ,,Angazhimi juaj për të krijuar një Forcë të integruar tregon se FSK-ja është një lider në iniciativat e reformës shoqërore.''Në fund të letrës së urimit, gjenerali amerikan JosephDunfort lavdëron edhe përkushtimin e udhëheqjes së FSK-së duke u shprehur:, Më rastin e përvjetorit tuaj ju lavdëroj juve dhe pjesëtarët e FSK në arritjen tuaj në rekrutimin dhe integrimin e 61 serbëve të Kosovës në FSK''.Gjeneral Joseph F. Dunford është kryetari i 19-të me radhë i Shefave të Shtabit, është oficeri në rangun më të lartë në SHBA, dhe njëkohësisht këshilltar kryesor ushtarak i Presidentit të SHBA-ve, Sekretarit të Mbrojtjes dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Berisha zhvilloi takime zyrtare gjatë konferencës Karta e Adriatikut-A5

Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Rrustem Berisha dhe delegacioni që e shoqëronte në përbërje, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane të MFSK-së, Faruk Geci dhe kolonel Fadil Hadergjonaj, këshilltar ushtarak i ministrit, zhvilluan disa takime dypalëshe në Ohër të Republikës së Maqedonisë, gjatë punimeve të konferencës SHBA- Karta e Adriatikut-A5. Fillimisht Ministri Berisha dhe delegacioni i tij u takuan me ministren e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, zonjën RadmillaShekerinska-Jankovska. Në takimin e përbashkët të dy ministrave u folë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive dhe dy vendeve.Ministri Berisha i shprehu ministres Shekerinska gatishmërinë e FSK-së për pjesëmarrje në operacione jashtë vendit me kapacitetet aktuale, pastaj u fol për shkollimin e kadetëve të FSK-së nga radhët e komuniteteve pakicë në Akademinë e Mbrojtjes të Maqedonisë, për gatishmërinë e FSK-së për të ofruar trajnime në Qendrën e Trajnimit të FSK-së për Kërkim- Shpëtim të personelit



të Ushtrisë së Maqedonisë, si dhe me theks të veçantë, folën për nevojën për mbështetje të Kosovës në rrugën e saj për anëtarësim në iniciativa rajonale dhe më gjerë. Ministri Berisha në Ohër zhvilloi një takim edhe me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Bullgarisë, zotëri KrasimirKarakachanov, me të cilin biseduan për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në rajon dhe më gjerë.Krahas kësaj, ministri Berisha së bashku me homologun bullgar folën edhe lidhur me inicimin e proceduarave për arritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive dhe dy vendeve në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, si dhe për kapacitetet trajnuese në fushën e Policisë Ushtarake, që posedojnë Forcat e Armatosura të Bullgarisë, e që do të ishin të dobishme për FSK-në.Gjithashtu, ministri Berisha zhvilloi takim bilateral edhe me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Malit të Zi, PredragBoshkoviq, të cilin e uroi, me këtë rast, për anëtarësimin e Malit të Zi në NATO, si dhe i shprehu konsideratën për marrëdhëniet e mira ndërmjet dy ministrive dhe dy vendeve.Ai në fund, zhvilloi takim edhe me delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë të prirë nga drejtori i Departamentit për Politika dhe Plane, PetarMehatov, me të cilin biseduan për marrëdhëniet e shkëlqyera në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes ndërmjet të dyja vendeve dhe dy ministrive dhe për shkëmbimet e shumta dhe aktivitetet e gjithanshme në kuadër të marrëveshjes dypalëshe të bashkëpunimit.

Komandanti i FSK-së mori pjesë në ceremoninë e pensionimit të gjeneralit Frederick 'Ben' Hodges

Komandanti i Forcës të Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ishte pjesëmarrës në ceremoninë e përfundimit të detyrës dhe pensionimit të komandantit të Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant FrederickBenjamin "Ben" Hodges, e cila u mbajt më 15.12.2017 në Gjermani. Komandanti i FSK, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast e ka falënderuar gjeneralin Hodges për mbështetjen e pakursyer të tij dhe të Komandës Amerikane për Evropë, për ndihmën që i kanë dhënë Kosovës në përgjithësi dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në veçanti.Gjatë kësaj ceremonie komandanti i FSK-së Rrahman Rama ka takuar edhe Komandantin e Komandës së SHBA-ve për Evropë dhe Komandant Suprem i Forcave Aleate të NATO-s, gjeneral Curtis M. Scaparrotti, si dhe disa shefa të Mbrojtjes të vendeve partnere.



Gjeneral Rama morri letër urimi edhe nga komandanti i Ushtrisë së Turqisë, gjeneral Hulusi Akar

Komandanti i Forcë së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama me rastin e ,,Ditës së FSK-së'' ka marrë një letër urimi nga komandanti i Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneral HulusiAkar.Gjenerali Akar nëpërmjet kësaj letre ka përshëndetur dhe uruar komandantin e FSK-së dhe nëpërmjet tij të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës me rastin e 27 Nëntorit – "Ditës së Forcës''.Në letrën e urimit të komandantit të Forcave të Armatosura të Turqisë, gjeneral HulusiAkar thuhet: ,, Pres me padurim zhvillimin e mëtejshëm të lidhjeve të shkëlqyeshme të miqësisë dhe bashkëpunimit midis Forcave tona të Armatosura, me qëllim të arritjes së objektivave të përbashkëta për sigurimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit''.Gjeneral Akar përfundon letrën e tij me dëshirat më të mira për gjeneral Ramën dhe pjesëtarët e FSK-së duke iu uruar shëndet dhe suksese të mëtejme.

Zëvendësministri Agim Çeku dekoroi me medalje atasheun e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës sot u zhvillua ceremonia lamtumire për Atasheun e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel RichardParry, i cili për katër vite ka qenë akredituar Atashe i Mbrojtjes për Republikën e Kosovës.Me këtë rast, zëvendësministri Agim Çeku, në emër të ministrit të FSK-së, Rrustem Berisha i dorëzoi një Mirënjohje atasheut britanik, nënkolonel Parry-t, për angazhimin e pakursyer në ngritjen dhe avancimin e nivelit të bashkëpunimit në fushën e sigurisë ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës.Zëvendësministri Çeku lavdëroi punën dhe angazhimin shumëvjeçarë të atasheut Perry, që nga misioni i tij i parë në Kosovë e deri tek detyra e atasheut në tri vitet e fundit, ku intensiteti i marrëdhënieve të MFSK/FSK-së me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcave të saj të Armatosura kanë qenë në vazhdimësi të shkëlqyera, dhe falë gatishmërisë së Mbretërisë së Bashkuar janë intensifikuar edhe më tutje.Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i ndau ,,Medalje për shërbim vetëmohues'' atasheut të Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, duke i shprehur me këtë akt të gjithë mirënjohjen për bashkëpunimin e shkëlqyer, koordinimin e vazhdueshëm dhe gjithë angazhimin e Mbretërisë së Bashkuar, përkatësisht të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura dhënë Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Nga ana e tij, nënkolonel RichardParry falënderoi zëvendësministrin Çeku për Mirënjohjen dhe komandantin Rama për Medaljen si dhe shprehu falënderimin e tij për të gjithë oficerët e FSK-së, të cilët, siç u shpreh ai, kanë qenë shumë bashkëpunues gjatë 4 viteve të punës së përbashkët.



Komandanti i FSK-së priti me ceremoni ushtarake shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së



(vijon nga faqja 1)

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), gjenerallejtënant Rrahman Rama, deklaroi se FSK çdo herë ka bashkëpunuar më FARSH dhe se në të ardhmen ky bashkëpunim do të thellohet edhe më shumë, duke përfshirë edhe fusha të tjera të sigurisë, por edhe shkëmbimin e përvojave të të dy ushtrive. Mund të them se Forca e Sigurisë së Kosovës po e përmbyll një vit të suksesshëm dhe pjesë e këtij suksesi padyshim janë edhe Forcat e Armatosur të Shqipërisë. Ne diskutuam edhe për thellimin e bashkëpunimit edhe për vitet e ardhshme. Absolutisht ne do ta kemi këtë përkrahje dhe kemi nevojë për eksperiencat e shtetit shqiptar dhe të ushtrisë shqiptare, në veçanti në aspektin e integrimit në strukturat veri-atlantike",-tha komandanti i FSK-së.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të FARSH-së, gjenerali Bardhyl Kollçaku u shpreh i kënaqur më të arriturat e FSK-së që nga formimi i saj, duke theksuar bashkëpunimin me Forcat e Armatosura si dhe ndihmën e FSK-së në operacionin e fundit pas përmbytjeve të disa zonave në Shqipëri."Jam shumë i mrekulluar nga prezantimi, por më shumë nga progresi i FSK-së në këtë periudhë të shkurtër të lindjes dhe zhvillimit duke arritur Kapacitete e Plota Operacionale. Përfitoj nga rasti ta falënderoj gjeneral Ramën, ministrin e Mbrojtjes dhe Qeverinë e Kosovës për ndihmën e menjëhershme profesionale në rastin e emergjencave që kishim në Shqipëri për shkak të përmbytjeve. FSK-ja e tregoi veten jo vetëm në reagimin e menjëhershëm por edhe me profesionalizimin e anëtarëve të saj, duke inspektuar dhe duke kryer rekonicion xhenier në urat e dëmtuara dhe duke ndihmuar popullsinë në zonat afektuaka dhe po ashtu dhe me sasinë e urave që dhuroi për FARSH.

Ne jemi të vendosur ta mbështesim transformimin nga FSKnë FAK brenda ndryshimeve kushtetuese në konsultim me partnerët. Jemi të vendosur që bashkëpunimin ta thellojmë sidomos në fushën e trajnimit, edukimit por edhe të stërvitjeve, pa e lenë pas dore edhe mundësinë që FSK të jetë pjesë në Operacionet e NATO-s për të kontribuar në sigurinë rajonale dhe më gjerë së bashku më Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sepse niveli profesional dhe përgatitja e lejojnë një mundësi të tillë, pra duke shikuar të gjitha modalitetet", -përfundoi gjeneral Kollçaku.

FSK-ja dislokohet në operacionin humanitar në Shqipëri

Me vendim të ministrit Rrustem Berisha dhe me urdhër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës, një kontingjent i FSK-së, në përbërje prej 37 pjesëtarëve, me 19 automjete dhe 1 autokranTerex, u nis sot (07.12.2017) për të marrë pjesë në operacione humanitare në Republikën e Shqipërisë.Në përcjellje të kontingjentit të FSK-së, në pikën kufitare Kosovë-Shqipëri ishte edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore(KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Mbështetje Operacionela(BMO), kolonel AvdiRraci si dhe oficerë të lartë të MFSK/ FSK-së.

Në pikën kufitare në Vërmicë gjeneral Rama u prit nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneral Dedë Prenga si dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, z. QemajlMinxhozi.Në përcjellje të kontingjentit, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha se Presidenti dhe Kryeministri na kanë angazhuar për



të ofruar kapacitetet tona në ndihmë humanitare për Republikën e Shqipërisë. Ne si Forcë kemi marrë Urdhrin operacional dhe jemi këtu sot. FSK-ja gjithmonë ka dëshmuar që është Forcë në shërbim jo vetëm të qytetarëve të Kosovës, por edhe të qytetarëve të shteteve tjera duke u bazuar në nevojat që i kanë. Bazuar në ligjet tona për dislokim për aktivitete humanitare janë marrë të gjitha masat dhe në kuadër të mundësive dhe kapaciteteve që kemi do t'i vijmë në ndihmë, në këtë rast, ushtrisë dhe autoriteteve tjera shqiptare, me qëllim që sado pak t'i sanojmë dëmet e shkaktuara nga përmbytjet në Shqipëri.

Ndërsa, gjenerali shqiptar Dedja ka falënderuar popullin dhe Qeverinë e Kosovës e në veçanti Forcën e Sigurisë së Kosovës për shpejtësinë e reagimit si dhe gatishmërinë për mbështetjen e popullit të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë, në përballimin e situatës dhe sanimin e pasojave nga vërshimet e ditëve të fundit.Para se të përshëndetej me kontingjentin e FSK-së, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i dorëzoi Urdhrin komandantit të Kontingjentit të FSK-së, duke i dëshiruar suksese në operacion gjatë kohës së qëndrimit dhe veprimit në Republikën e Shqipërisë, aty ku e kërkon nevoja, për sa kohë që do të jenë nën urdhrat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si drejtues të operacionit.





Certifikohen pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Qendrën e Trajnimit të Kërkim–Shpëtim të FSK-së



Në Kazermën "Evropianet e Rinj" në Pomozotin,më 02.12.2017, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët përfunduan trajnimin për Kërkim-Shpëtim Urban, niveli bazik dhe i avancuar.Trajnimi ,,Kërkim-Shpëtimi Urban–Niveli Bazik dhe i Avancuar" është trajnimi i parë, për vendet e regjionit, i organizuar dhe i realizuar nga Qendra e Trajnimeve të Kërkim-Shpëtimit, qysh nga hapja zyrtare e kësaj qendre të trajnimeve.Në ceremoni e certifikimit të pranishëm ishin edhe zëvendësministri Brahim Mehmetaj, gjeneral brigade ZymerHalimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, koloneli Shaip Haziri, komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së dhe FARSH-së.

Zv. ministri Mehmetaj, me rastin e ceremonisë së certifikimit tha se ka nderin dhe privilegjin ,,që t' ju uroj certifikimin me sukses pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) në trajnimin e kërkim-shpëtimit urban të nivelit Bazik dhe të avancuar. Bashkëpunimi i deri sotëm me FARSH-në dhe FSK-në ka sjell nënshkrimin e disa marrëveshjeve me rëndësi të veçantë për të dy shtetet. Vizita e ministres së Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. OltaXhaçka ishte mjaft produktive dhe u konfirmua nga të dyja institucionet tona respektive; se bashkëpunimi ynë vetëm sa do të avancohet dhe thellohet edhe më tutje".Zv. ministri Mehmetaj uroi pjesëtarët e FARSH-së, duke ju dëshiruar suksese në misionin e tyre, dhe premtimin për mbështetjen e vazhdueshme të MFSK-së dhe FSK-së.Kurse, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri, tha se: ,,Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, ditë për ditë po arrin të ndërtojë themelet e një qendre me karakter ndërkombëtare. Sot pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë po certifikohen, dhe ky është certifikimi i parë i kësaj qendre, me karakter regjional".Ndërsa, kapiteni Gentian Tota, udhëheqës i togut të kërkim-shpëtimit të FARSH-së, tha: ,,është një emocion shumë i madh, pasi që, në gjithë karrierën time ushtarake, arrita ta realizoi edhe këtë trajnim me sukses, gjë që, mua mu plotësuar edhe kjo ëndërr, dhe një ndjenjë e kahëmotshme që ne jemi një komb. Ky trajnim më ka lënë mbresa me profesionalizmin dhe disiplinën e treguar nga instruktorët tuaj". Kapiteni Tota ndau një Plakat për t`u kujtuar si njësiti i parë i certifikuar në qendrën e kërkim-shpëtimit të FSK-së". Dy skuadrat e togut të kërkim-shpëtimit të Brigadës së Mbështetjes Rajonale të FARSH-së trajnimin intensiv e kanë realizuar në Qendrën Trajnuese për Kërkim Shpëtim në Regjimentin e Mbrojtjes Civile, duke filluar nga data 12 nëntor-1 dhjetor 2017.Trajnimi bazik dhe i avancuar i kërkim-shpëtimit ishte trajnim dinamik dhe intensiv, ku u trajtuan temat në lidhje me katastrofat e ndryshme natyrore apo njerëzorë, ,,tema që lidhen me shembje dhe kolapse të strukturave të ndryshme, intervenimet mjekësore të shpejta, kërkime në struktura të rrënuara në mënyrë të detajuar, njohuri bazike për sistemin e komandës së incidentit, gjithashtu u aftësuan dhe u sprovuan me lëshime të ndryshme nga lartësitë shkëmbore duke u mësuar lidhjet, nyjat dhe lëshimet me litarë.Për pjesëtarët e FARSH-së, realizuan edhe vizita dhe aktivitete sociale me qëllim të familjarizimit me të kaluarën historike të popullit të Kosovës. Ata ishin pjesëmarrës edhe në organizimet për ,,Ditën e Forcës" të FSK-së.



Xhenierët e FSK-së dhe të FARSH-së ndërtojnë urën mbi lumin Devoll

Batalioni i Xhenios i Forcës së Sigurisë ës Kosovës, së bashku me ekipet mbështetëse për komunikim, ekipin mjekësor, ekipin e Policisë së Forcës si dhe ekipin e specialistëve për ndërtim, ditë më parë u dislokuan në Republikën e Shqipërisë për t'iu dalë në ndihmë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Pas dislokimit në Shqipëri, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim me Forcat e Xhenios të Ushtrisë së Shqipërisë, kanë filluar me punë konkrete në terren. Pjesëtarët e FSK-së gjatë qëndrimit atje kanë kryer një numër të madh të aktiviteteve si: transportimin e urës lëvizëse metalike 52 metra të gjatë, të cilën e kanë shkarkuar në Batalionin e Xhenios së FARSH-së. Së bashku me specialistë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë bërë vlerësimin e terrenit; rikonicionin e tetë (8) urave të dëmtuara nga përmbytjet e fundit në rajone të ndryshme të Shqipërisë; kanë identifikuar lokacionin në rajonin e Korçës mbi lumin Devoll, ku kanë vendosur urën e FSK-së në gjatësi prej 52 metrash. Po ashtu pjesëtarët e FSK-së kanë ndihmuar xhenierët e Ushtrisë së Shqipërisë në vendosjen e një ure në Dropull të Gjirokastrës. Ekipet e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) kanë ndihmuar Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në rajone të ndryshme të Shqipërisë, pas vërshimeve të mëdha që ndodhen atje. FSK-ja në rast nevoje është e gatshme që t'u përgjigjet, qoftë me personel, qoftë me pajisje teknike, kërkesave shtesë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.





Ministri Rrustem Berisha në ndërrimin e moteve vizitë ushtarëve të FSK-së në detyrë

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës Rrustem Berisha i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, në çastet e ndërrimit të moteve ishin në vizitë në kazermën e FSK-së »Adem Jashari» në Prishtinë, ku vizituan ushtarët në detyrë. Me këtë rast Ministri dhe Komandanti uruan ushtarët dhe oficerët në detyrë, duke ju dëshiruar shëndet, suksese në planin individual, në karrierë dhe ditë edhe më të suksesshme për FSK-në dhe gjithë qytetarët e Kosovës.

Është traditë në FSK dhe MFSK që të bëhet vizita në ndërrimin e moteve tek ushtarët në kazerma, për të nderuar dhe për të uruar ata që janë në krye të detyrës dhe në shërbim të qytetarëve, vendit dhe shtetit, në natën më të gëzuar të vitit.



Certifikohen pjesëtarë të Forcë së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës



Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), më 07.12.2017 u realizua certifikimi i pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës, gjithsej 30 pjesëtarë, në trajnimin e zhvilluar për ndihmë të parë.Në këtë ceremoni të pranishëm ishin zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtori i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë për FSK-në, kolonel Xhevdet Tahiri, komandanti i Kompanisë së Mjekësisë nënkolonel HamideOsaj, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare-Veri, nënkolonel Mentor Shabani, drejtori i Drejtorisë për Trajnime të Specializuara në Policinë e Kosovës nënkolonel EkremRacaj, nëntoger JustinParks oficer i Operacioneve MEDEVAK, kapiteni NickolasStidharr CMSE (Ekipi për Mbështetje Civilo Ushtarake i Ambasadës Amerikane), nënkolonel MilaimMusliu komandant i NNJRK-së.Në fjalën e tij, gjenerali Gëzim Hazrolli tha: "Falënderoj Ambasadën Amerikane për mbështetjen dhe hap pas hapi po bëhemi të gatshëm për të qenë ofrues të sigurisë dhe jo vetëm konsumues. Duhet të jemi të ndërveprueshëm. Ky është edhe qëllimi i komandantit të FSK-së pra, bashkëpunimi me të gjitha institucionet. Prandaj në këtë funksion është edhe puna të cilën e bëjmë dhe ndihma që ne japim për shpëtimin e jetëve të njerëzve dhe ky ka qenë edhe qëllimi i këtij trajnimi të përbashkët".Gjenerali Gëzim Hazrolli duke iu drejtuar të sapo certifikuarve tha: "Këto njohuri nuk do të kenë vlerë nëse nuk i avancojmë dhe nuk i përdorim si për të mirën e qytetarëve ashtu edhe për të mirën tonë gjatë punës së përditshme, prandaj kërkoj nga nënkolonelët e Policisë së Kosovës dhe të gjithë ju, që këto njohuri të fituara t'i avanconi për të mirën e përgjithshme".Ndërkaq kapiteni NickolasStidharr falënderoi për mundësinë që i është ofruar dhe theksoi se "zyra jonë ka një bashkëpunim të mirë si me Policinë e Kosovës ashtu edhe me FSK-në dhe gjëja më e mirë që kam parë, qe gjashtë muaj, sa jam këtu është ky bashkëpunim i shkëlqyer në mes Policisë së Kosovës dhe FSK-së".Nënkoloneli Racaj nga Policia e Kosovës tha se "është privilegj të jesh pjesë e sukseseve të tilla, ku marrin pjesë institucionet e sigurisë dhe të rendit". Ai falënderoi të gjithë për mundësinë e dhënë për këtë trajnim dhe shtoi: ,,ky trajnim do të na duhet së pari neve në punën tonë të përditshme, e gjithsesi edhe për qytetarët dhe shpresoj se do të vazhdojmë edhe me bashkëpunime tjera në shumë fusha me interes të përbashkët".Trajnimi është mbajtur në Kompaninë e Mjekësisë së FSK-së. Është mbështetur nga ekipi për Mbështetje Civilo-Ushtarake i Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë. Këtë trajnim që ka zgjatur tri ditë e kanë ndjekur 15 pjesëtarë të FSK-së dhe 15 pjesëtarë të Policisë së Kosovës.

Një delegacioni i atasheve ushtarak të akredituar në Turqi vizitoi FSK-në

Në Kazermën ,,Adem Jashari" të Komandës Tokësore të FSK-së në Prishtinë, sot (02.12.2017) për vizitë zyrtare qëndroi një delegacion i atasheve ushtarak të akredituar në Turqi -përfaqësues nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Finlanda, Norvegjia, Australia dhe Holanda. Delegacioni shoqërohej nga nënkoloneli Bekim Osmani, atasheu ushtarak i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Turqi. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, së bashku me kolonelin Jeton Dreshaj, i falënderoi atashetë për vizitën dhe kohën që kanë ndarë që të jenë sot së bashku në FSK. Gjenerali Rama, gjithashtu i ka njoftuar atashetë edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, misionin, strukturën, shkollimin, bashkëpunimin, mbështetjen e shteteve tjera, si dhe me transformimin e FSK-së. Mysafirët u pritën edhe nga shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, koloneli Naim Haziri, shefi i Operativës së KFT-së, kolonel Bashkim Shillova, shefi i personelit të KFT-së, kolonel Hasan Hoxha si dhe eprorë të FSK-së. Ata përmes një brifingu informues; rreth strukturës, misionit aktual të Forcës se Sigurisë së Kosovës, kapaciteteve të FSK-së, trajnimeve individuale dhe kolektive, shkollimit si brenda institucionit të FSK-së, dhe jashtë vendit i njoftoi togeri NysretBuzhala. Delegacioni nga Turqia, gjatë ditës vizitoi edhe Qendrën për Studime Universitare (QSU) të FSK-së, ku nga kapiteni Vegim Krelani, u njoftuan me QSU-në, pastaj realizuan vizita në sallat e mësimit, bibliotekën, dhomat e fjetjes, sallën e fitnesit fizik si dhe bashkëbiseduan me kadetët e kësaj Qendre.Mysafirët nga Turqia do të qëndrojnë për vizitë tre ditore në Kosovë, ku gjatë kësaj kohe do të realizojnë edhe vizita në vendet historike të Kosovës.



Gjeneral Cikaqi priti gjeneralin Ralf Hoffmann



Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi, priti në vizitë zyrtare drejtorin e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT-it), gjeneral brigade Ralf-Hoffmann.Gjeneral Cikaqi e njoftoi gjeneralin Hoffmann për angazhimet e KDS-së, trajnimet si dhe aktivitetet që zhvillohen në kuadër të bashkëpunimit me KFOR-in dhe ekipet e NALT-it.Gjenerali Hoffman takoi edhe stafin e lartë të KDS-së, si dhe pjesëtarët tjerë të FSK-së të cilëve ju shprehu gatishmërinë e tij për të ndihmuar edhe në të ardhmen kudo që paraqitet nevoja.

Gjeneral Cikaqi falënderoi gjeneralin Haffman për angazhimin dhe ndihmën e oficerëve të NALT-it. Ata u dakorduan për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen me qëllim të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta.Më pas vizituan ambientet e KDS-së, ku patën mundësi që nga afër t'i shohin fushat e stërvitjes dhe aktivitet e pjesëtarëve të FSK-së. Me këtë rast gjenerali Hoffmann u shpreh: "ndjehem i mahnitur me atë që po shoh tek instruktorët e KDS-së, përkushtimin dhe angazhimin e tyre".Ekipet e NALT-it në vazhdimësi kanë dhënë kontribut në ndihmë KDS-së për nxjerrjen e dokumenteve dhe programeve të stërvitjes, si dhe zhvillimin e ligjëratave nëpër trajnime të ndryshme.

Diplomojnë kadetë nga radhët e komuniteteve

Në kazermën ushtarake ,,Goce Dollçev" të Shkupit, dje (01.12.2017) u mbajt ceremonia e diplomimit të kadetëve të rinj nga Maqedonia, Bosnja Hercegovina, Mali i Zi dhe Kosova. Nga FSK-ja diplomuan dy kadetë(një nga radhët e komuniteti serb e tjetri nga ai boshnjak) si dhe dhanë betimin edhe dy kadetë të rinj, po nga radhët e komuniteteve.Në ceremoninë e diplomimit mbajtur më 1 dhjetor 2017, morën pjesë ministrja e Mbrojtjes së Maqedonisë, znj. RadmillaSheqerinska, komandanti i Akademisë Ushtarake kolonel OrcePopovski, familjarë të kadetëve, oficerë dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë, të Ministrisë për FSK-në, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, AzeminaQullum-shefe e Zyrës për Komunitete, si dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë të pranishmit i përshëndeti ministrja RadmillaSheqerinska, kurse në emër të Ministrisë për FSK-në, AzeminaQullum, shefe e Zyrës për Komunitete e cila ndër të tjera tha: "Jam e privilegjuar që në emër të ministrit Rrustem Berisha dhe komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant RrahmanRamës të ju përshëndes, në këtë ngjarje me rëndësi me rastin e diplomimit me sukses kadetëve të rinj". Ajo, gjithashtu ka përshëndetur edhe stafin e Akademisë së Mbrojtjes, për kontributin e dhënë në shkollimin e kadetëve të rinj.Znj. Qullum gjithashtu ka uruar edhe kadetët e FSK-së, nga radhët e komuniteteve, të cilët me sukses kryen akademinë duke thënë: "Kjo është edhe një dëshmi e bashkëpunimit të suksesshëm të dyja ministrive tona për ndërtimin e paqes dhe qetësisë në rajon". Duke iu drejtuar kadetëve të diplomuar të FSK-së, ajo tha: "Kadetë të diplomuar, gjatë shkollimit tuaj ju keni treguar sukses, dhe keni dhënë një zotim të madh dhe përkushtim profesional për t'u bërë oficerë të përgatitur mirë. Këtë e keni arritur dhe unë ju përgëzoj!"Ndërsa, në Ambasadën e Kosovës në Shkup, në prani të konsullit të Republikës së Kosovës z. Agim Krasniqi, gjeneralit Enver Cikaqit, zyrtares së MFSK-së, znj. AzeminaQullum e të oficerëve



të lartë të FSK-së dhe të Akademisë së Maqedonisë, dhanë betimin dy kadetët e rinj të FSK-së, pjesëtarë të komuniteteve, të cilët për katër vite do t'i vazhdojnë studimet në akademinë ushtarake "Gjeneral MihailoApostollski" në Shkup.

Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione vizitoi MFSK-në

Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione me kryetare Duda Balje, vizitoi sot (20.12.2017) Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK-në), ku mbajti takim me shefen e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore në MFSK, zonjën Halime Morina si dhe me përfaqësueset femra të disa departamenteve të kësaj ministrie, të cilat janë në pozita kyçe në MFSK, për t'u njoftuar për nivelin e të drejtave të njeriut dhe barazinë gjinore në MFSK.Në fjalën përshëndetëse ministri i FSK-së z. Rrustem Berisha theksoi se në MFSK i kushtohet rëndësi përfshirjes së femrave duke thënë se shkalla e përfshirjes është e kënaqshme. Femra në MFSK ka arritur në pozitën dhe rolin e saj falë përgatitjes profesionale, fizike dhe psikike që kërkohen në këtë institucion. Ato japin kontributin e tyre kudo që kërkohet si brenda institucionit ashtu edhe



në përfaqësimin me dinjitet jashtë vendit. "Gjinia femërore në MFSK/FSK nuk është vetëm për plotësim të numrit, por përqindja e pjesëmarrjes së tyre përfaqëson peshën e saj në proceset vendimmarrëse të institucionit dhe na bënë të ndihemi krenarë me punën e tyre si brenda ashtu edhe jashtë shtetit. Një pjesë e tyre i përkasin edhe të kaluarës së lavdishme-Ushtrisë Çlirimtare. Angazhimi jonë nuk do të mungojë as në të ardhmen për krijimin e ambientit të përshtatshëm të punës së femrave në institucionin tonë"-tha ministri Berisha në fjalën përshëndetëse.Nga ana e saj kryetarja e Komisionit parlamentar znj. Duda Balje premtoi bashkëpunim dhe ndihmë profesionale e energji pozitive kurdo që është e nevojshme. Ndër të tjera ajo tha: "Do të punojmë për ju sa herë që keni nevojë për ndihmën tonë".Gjatë takimit zonja Halime Morina prezantoi punën e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MFSK/FSK në raport me femrat e Ministrisë dhe Forcës, si dhe u diskutuan arritjet dhe sfidat për përfaqësimin e femrës në proceset vendimmarrëse dhe ngritjen e saj në karrierë. Nga të gjeturat e kësaj Njësie u tha që në MFSK/FSK nuk ka shkelje të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore dhe se gjithçka është e rregulluar me ligjet e Republikës së Kosovës.

Pjesë e delegacionit nga Komisioni parlamentar ishin: Duda Balje, Luljeta Veselaj-Gutaj, Mexhide Mjaku-Topalli dhe Saranda Bogujevci, ndërsa nga pala pritëse e MFSK-së ishin Halime Morina, Luljeta Rexhepi, FahrijeSadiku, Hadije Binaku, Remzie Morina dhe Leonora Gjinovci.

KDS-ja realizoi ushtrimin „Marshimi i dhjetorit"



Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në kuadër të planit vjetor të stërvitjes, realizoi edhe marshimin administrativ - kondicional të koduar "Marshimi i dhjetorit".Ky marshim tashmë është bërë tradicional për KDS-në dhe realizohet nga pjesëtarët e saj. Këtë vit ky marshim ishte më i veçantë sesa herëve tjera sepse pjesëtarët e KDS-së marshuan larg lokacionit të tyre, në terrenin e bjeshkëve të Pashtrikut.Ky marshim pati edhe simbolikën e vet, sepse pikërisht më 14 dhjetor 1998 në këtë pikë ranë 41 luftëtarë të UÇK-së në krye me komandantin Mujë Krasniqi. Atë ditë ata ishin duke u kthyer nga Shqipëria me armatim dhe municion, për t'ju bashkuar bashkëluftëtarëve të UÇK-së për çlirimin e atdheut.KDS-ja përveç stërvitjeve të planifikuara që janë misioni i saj, zhvillon edhe marshime, me qëllim që të testojë aftësitë dhe përgatitjet e tyre fizike. Edhe në këtë marshim u dëshmua se pjesëtarët e KDS-së janë të gatshëm dhe të përgatitur mirë edhe për marshime në terrene të vështira malore. Pjesëtarët e KDS-së përveç marshimit në këtë ditë të shënuar, patën rastin të takojnë edhe familjarët e të rënëve më 14 dhjetor 1998 në bjeshkët e Pashtrikut.Me këtë rast u bënë homazhe në vendin e rënies së dëshmorëve, ndërsa komandanti i KDS-së gjeneral brigade Enver Cikaqi, ju drejtua familjarëve të dëshmorëve dhe pjesëtarëve të KDS-së me fjalë nderimi dhe përkujtimi: "Dita e14 dhjetorit e vitit 1998 ishte një goditje e rëndë për UÇK-në dhe për ju si familjarë, mirëpo falë sakrificës së tyre, falë gjakut të derdhur të dëshmorëve ne sot gëzojmë lirinë. Kur kujtojmë veprën dhe sakrificën e tyre, dhe kur shohim avancimin e institucioneve të sigurisë dhe shtet- ndërtimin, që ishte edhe pikësynim i dëshmorëve, na lehtësohet dhimbja për të rënët"."Marshimi i dhjetorit" që është një prej aktiviteteve të KDS-së në kuadër të planit të punës u vlerësua i suksesshëm dhe i përgatitur mirë.

Studentë të Kolegjit ILIRIA qëndruan tri ditë në kazermën e FSK-së në Istog

Një grup i studentëve të Kolegjit Iliria, duke qëndruan për tri ditë radhazi në mjediset e kazermës "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, të pajisur me uniforma dhe duke ndjekur të gjitha rregullat ushtarake, patën mundësi që të përjetojnë ndjenjat dhe emocionet e të qenit ushtarë.Për t'i përshëndetur studentët për këtë aktivitet, dje në mjediset e kazermës në Istog u organizua një ceremoni, ku ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, Prof.Dr. Mixhaid Reçi, komandanti i Batalionit të Dytë nënkolonel MehmetLladrovci si dhe oficerë dhe nënoficerë të BRSH-së.Zëvendëskomandanti i BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, pasi i falënderoi studentët për gatishmërinë dhe vullnetin e tyre që t'i kalojnë këto ditë së bashku me pjesëtarët e FSK-së, ndër tjera tha: "Jeta ushtarake ka sfida dhe vështirësi. Gjatë qëndrimit tuaj, ju jeni familjarizuar me jetën ushtarake dhe sigurisht se jeni ballafaquar edhe me disa prej këtyre sfidave, si disiplinën, jetën brenda rregullave, ushtrimet fizike, praninë e armëve etj. Se bashku me stafin tim e kemi



përcjellë mbarëvajtjen e këtij aktiviteti dhe e kemi mbështetur me të gjitha kapacitetet realizimin e suksesshëm të tij. Forca e Sigurisë së Kosovës është shtëpi e të rinjve të vendit tonë dhe si e tillë do të jetë gjithmonë e hapur për të realizuar aktivitete të përbashkëta me të rinjtë e vendit tonë, më qëllim që të gjithë së bashku të kontribuojmë sa më shumë në zhvillimin e atdheut tonë".Ndërkaq, në emër të Kolegjit ILIRIA të pranishmëve ju drejtua Prof.Dr. Mixhaid REÇI"Ne i përcjellim çdo ditë aktivitetet tuaja, sepse nga ju varet jeta dhe siguria jonë. Puna juaj ndikon pozitivisht tek ne. Studentët e Kolegjit ILIRIA këtu kanë pasur mundësinë që të shohin se si është të punohet ditën, natën, me orar të stërzgjatur dhe duke u përballur me sfida të ndryshme. Jam shumë i nderuar që studentët tonë po i shoh si ushtarakë dhe do të doja që çdo i ri të kalojë në ketë fazë, sepse këtu në FSK mund të shohin guxim dhe aftësi. Ne kemi një rini të guximshme dhe me këtë mburremi si shoqëri".Gjatë kësaj periudhe këta të rijnë kanë praktikuar disa nga detyrat thelbësore të FSK-së, sipas plan- programit të përgatitur nga BRSH-ja. Kanë praktikuar aktivitete kryesore të një dite të zakonshme në FSK, duke filluar nga ngritja e Flamurit, ushtrimet fizike, histori ushtarake, njoftimi mbi misionin, strukturën dhe detyrat e FSK-së, njohjen me rregullore rreshtore, njohjen me armë, vlerat ushtarake, aktivitete sportive etj.Në fund të këtij aktiviteti studentët e Kolegjit Iliria janë ndarë shumë të impresionuar me aktivitetet e BRSH-së, dhe se kjo përvojë do jetë udhërrëfyes për ta në jetën e tyre personale dhe profesionale. Ata u shprehën të kënaqur me mundësinë e dhënë dhe shprehën dëshirën që kjo mundësi t'ju ofrohet edhe të tjerëve.

Batalioni i Dytë i BRSH-së realizoi ushtrimin fushor „Ujku Vigjilent 3"

Në bazë të planit vjetor të stërvitjes së Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, Kompania 2C ka realizuar trajnimin e brendshëm tre mujor, nga data 18.09.2017 deri më 01.12.2017.

Në kuadër të këtij trajnimi është realizuar edhe ushtrimi fushor 72 orësh "Ujku Vigjilent 3", i cili ushtrim është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Dytë dhe ekzekutuar nga Kompania 2C.Ushtrimi është vëzhguar dhe vlerësuar nga ekipet vlerësuese të FSK-së.Gjatë realizimit të këtij ushtrimi pjesëtarët e Kompanisë 2C, dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht për përmbushjen e Misionit të Kompanisë, siç janë: Rikonicioni i terrenit, ngritja e pikave statike dhe mobile të kontrollit, patrullimet me automjete/blinda dhe reagimi në kontakt, manovrimi taktik me autoblinda, kordon kërkim, sulmi i planifikuar i bazës së armikut, reagimi në pritë, mbrojtja gjatë marshimeve rrugore, vetëmbrojtje e afërt, perimetri i sigurisë, navigim tokësor individual edhe ekipor, marshime kondicionale taktike, poligoni i qitjes, qitje e avancuar me municion real në nivel skuadre dhe fusha të tjera. Gjatë trajnimit tremujor të Kompanisë 2C, janë realizuar edhe teste vlerësuese individuale dhe ato grupore si testet fizike dhe akademike. Sipas vlerësimeve të stafit, Kompania 2C, dëshmoi se është e përgatitur dhe ka kapacitete të ekzekutoi operacione të ndryshme sipas misionit të paraparë, për të realizuar qëllimin dhe objektivat e komandantit të Batalionit të Dytë. Qëllimi i realizimit të këtij trajnimi dhe ushtrimi është për t'i mirëmbajtur, avancuar dhe profesionalizuar kapacitete ekzistuese.



FSK-ja përfundoi me sukses operacionet e deminimit për vitin 2017



Kompania e Deminimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, në fund të muajit nëntor 2017, ka përfunduar me sukses operacionit e deminimit humanitar gjatë sezonit veror dhe të pastrimit të fushëbetejave, sipas planit të veprimit për vitin 2017. Kompania e Deminimit e FSK-së, edhe gjatë këtij viti ka vazhduar bashkëpunimin shumë të mirë dhe profesional që e ka me ekipet e KFOR-it amerikan dhe me organizatat për pastrimin e fushave të rrezikshme që veprojnë në Kosovë.

Sipas raportit përmbledhës të Qendrës Koordinuese për Deminim në Ministrinë për FSK-në dhe të Kompanisë së Deminimit, pjesëtarët e kësaj kompanie që nga 1 prilli 2017, kur edhe kanë filluar operacionet humanitare për sezonin veror 2017, janë angazhuar çdo ditë pune në terren dhe sipas prioriteteve kanë punuar pandërprerë në këto lokacione: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së në Ferizaj (brenda kazermës) dy ekipe, në lokacionin "Parku i Lirisë" në Ferizaj, (jashtë kazermës) dy ekipe dhe një ekip ka punuar në Paldenicë komuna e Hanit të Elezit, deri më 30 nëntor, kur e kanë përfunduar punën në terren me sukses dhe kanë bërë dorëzimin e fushave tek Qendra Koordinuese për Deminim (QKD).Gjatë vitit 2017, ekipet e deminimit të FSK-së kanë pastruar gjithsej mbi 199906 metra katrorë, si dhe kanë zbuluar mbi 722 mjete të pashpërthyera, të cilat më pastaj i kanë asgjësuar, dhe 24 pjesë të mjeteve të ndryshme të bombave dhe kasetë-bombave.

Përpos deminimit humanitar dhe pastrimit të fushëbetejave, Kompania e Deminimit ka edhe Njësitë për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera (EOD), të cilat bëjnë kujdestari vazhdimisht 24 orë në ditë, gjatë 7 ditëve të javës, përgjatë gjithë vitit, në dy kazerma të FSK-së, në Prizren dhe në Pomozoton, si dhe aktivizohen për veprim sipas thirrjes së Policisë së Kosovës.

Gjatë këtij viti, deri më tani, kanë intervenuar sipas thirrjeve në 280 raste si dhe kanë demoluar dhe asgjësuar 710 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera si: granata, mina, bomba kasetore, projektil etj. Kompania e Deminimit pas përfundimit të sezonit veror, do të angazhohet në realizimin e planit të paraparë për sezonin dimëror, e që është; aksioni vullnetar i mbajtjes së ligjëratave në shkolla fillore dhe të mesme për vetëdijesimin e nxënësve nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera dhe mjetet piroteknike, si dhe realizimi i trajnimeve të ndryshme profesionale për pjesëtarët e kësaj kompanie.Falë punës profesionale, eksperiencës dhe disiplinës, edhe gjatë këtij viti pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit kanë kryer me sukses aktivitetet gjatë operacioneve për pastrimin e fushave të minuara pa pasur asnjë incident apo dëmtime tjera.

FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 65 • 14 Shkurt 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

FSK-ja dhe KFOR-i përuruan urën e restauruar mbi lumin Sitnica në Mitrovicë

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Cuoci si dhe udhëheqës lokalë dhe qytetarë të tjerë morën pjesë në ceremoninë e rihapjes së urës mbi lumin Sitnica në Mitrovicë, (30.01.2018) pas kryerjes së punimeve për riparimin dhe rindërtimin nga Batalioni i Xhenios së FSK-së në bashkëpunim me KFOR-in.

Me këtë rast, ministri Rrustem Berisha tha se Forca e Sigurisë së Kosovës po dëshmon çdo ditë e më shumë se me kapacitetet në kuadër të misionit të saj është e gatshme dhe e aftë të planifikojë dhe realizojë në tërësi projekte të infrastrukturës të cilat e lehtësojnë jetën e qytetarëve si dhe mundësojnë qarkullimin e lirë të njerëzve, automjeteve dhe mallrave në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Duke përcjellur përgëzimet e Qeverisë, ministri Berisha tha se tani me përfundimin me sukses të riparimit në urën mbi lumin Sitnica, xhenierët e FSK-së treguan profesionalizëm dhe përkushtim të lartë si dhe dëshmuan një gatishmëri për ndërveprim me trupat e KFOR-it gjatë kryerjes së punimeve.



Nga ana e tij, ministri Berisha deklaroi se ndjehet krenar për punën profesionale dhe vetëmohuese të pjesëtarëve të FSK-së, gjithashtu edhe për disiplinën dhe angazhimin ekipor të tërë ekipeve që punuan edhe gjatë ditëve të vikendit, vetëm e vetëm që kjo vepër të jetë sa më parë në shërbim të qytetarëve të Mitrovicës dhe lokaliteteve përreth.

Komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Couci tha se FSK-ja është Forcë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe se ne jemi krenar me punën e tyre dhe profesionalizmin e treguar. Ndër tjera ai tha: ,,Sikurse në këtë operacion të përbashkët, KFOR-i do të vazhdojë të mbështes FSK-në në zhvillimin e kapaciteteve të saj në kuadër të misionit që ka aktualisht. FSK-ja ka demonstruar profesionalizëm të lartë në operacione të tilla si ky", duke përfunduar se. Në urën mbi lumin Sitnica në Mitrovicë, punuan gjithsejtë 15 pjesëtarë të FSK-së me pajisje xheniere dhe 9 automjete, nga data 24 janar deri më datë 29 janar. Angazhimi kryesor ishte vendosja e dyshemesë së urës, me gjatësi 45,72 metra, gjerësi 4.20 metra, si dhe kryen inspektimin teknik të urës për çdo element metalik të vendosur aty, në mënyrë që ura e riparuar t'i përmbahet standardit në përballimin e peshës prej 50 tonelatave.

FSK-ja ka lehtësuar jetën e qytetarëve dhe ka mundësuar lëvizjen e lirë të udhëtarëve dhe automjeteve me ndërtim urash dhe projekte tjera humanitare edhe në Kramovik, Deçan, Krushevë e Vogël të Klinës, mbi lumin Drini i Bardhë, Mitrovicë dhe në lokalitete tjera të Kosovës, dhe me këtë ka dëshmuar profesionalizëm, gatishmëri si dhe përkushtim për të provuar në vepër investimin që populli i Kosovës po e bën për institucionet dhe se ato ua kthejnë përmes sigurisë dhe investimit në punë.

Vlen të theksohet se xhenierët e FSK-së kanë qenë të përfshirë edhe në operacionin humanitar pas vërshimeve në Republikën e Shqipërisë ku kanë punuar dhe asistuar në ndërtimin dhe montimin e urave si dhe pritet që të dislokohen përsëri për të vazhduar me operacione në Shqipëri, po për këtë qëllim, pra ndërtimin dhe montimin e urave të tipit modern Mabey Johnson.

Komandanti i FSK-së morri pjesë në Forumin Ndërkombëtar në Komandën e Forcave Ajrore të NATO-s në Gjermani



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Komandantit të Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjeneral major Timothy Mc Guire, mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Zjarrit Luftarak në Komandën e Forcave Ajrore të NATO-s në Gjermani.

Në Forumin Ndërkombëtar morën pjesë përfaqësues ushtarakë të më se njëzet vendeve anëtare të NATO-s, ku u diskutua lidhur me trendët e reja në teknologjinë e zjarrit luftarak, ndërveprueshmërinë e zjarrit indirekt në fushat luftarake, si dhe për mësimet e mësuara nga operacionet e tanishme.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama ka falënderuar përfaqësuesit e Ushtrisë Amerikane për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe për mundësitë e gjithanshme që po merr nga partnerët strategjikë në të mirë të avancimit dhe zhvillimit profesional të FSK-së.

Oficerë të FSK-së trajnohen në Mbretërinë e Bashkuar

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe këshilltari i tij ushtarak nga Mbretëria e Bashkuar, nënkoloneli Gregor Lindsay, (10.01.2018) përcollën tre oficerët e rinj të FSK-së, nëntogerët Besfort Kurteshi dhe Eugen Thaçi dhe togerin Ismail Hoxha, për në Mbretërinë e Bashkuar, për një trajnim profesional në akademitë më prestigjioze të Mbretërisë së Bashkuar.

Dërgimi i oficerëve të FSK-së, për trajnim profesional në Mbretërinë e Bashkuar shënon fillimin e një viti të suksesshëm të marrëdhënieve shumë të mira mes ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Këta pjesëtarë të FSK-së, paraqesin shembullin e rritjes së FSK-ja duke dëshmuar se udhëheqësit e saj të rinj janë oficerë profesionistë të gatshëm për sfidat që e presin në të ardhmen.

Nëntogeri Besfort Kurteshi do të jetë pjesë e Akademisë Ushtarake Mbretërore Sandhurst. Ky është kandidati i 18-të i FSK-së që shkollohet në këtë akademi ushtarake. Në Sandhurst, Kurteshi do të shërbejë së bashku me mbi 100 liderë të ardhshëm, pjesëtarë nga ushtria e Mbretërisë së Bashkuar dhe ushtritë e shteteve tjera.

Ndërsa, nëntogeri Eugen Thaçi do të qëndrojë në Edinburg të Skocisë, për një para-trajnim që drejtohet nga Shkolla e Trajnimit të Këmbësorisë. Nëntogeri Thaçi do të studiojë taktikat e Ushtrisë Britanike dhe do të mësojë të përdorë pajisjet britanike në kushtet e dimrit skocez. Pas këtij trajnimi sfidues, Thaçi do të shkojë edhe në Uells, ku do të jetë oficeri i dytë i FSK-së, për të kryer Kursin Luftarak për komandant të togës. Nëntogeri Thaçi si udhëheqës i ekipit në Ushtrimin ,,Shqiponja Patrolluese 2017", ka treguar aftësitë për komandimin e këmbësorisë. Megjithatë ai do të sfidohet ende nga trajnimi intensiv dhe kushtet e vështira që mund të gjenden në Uells.

Kurse togeri Ismail Hoxha, pas sukseseve në Akademinë Ushtarake Sandhurst, ku fitoi ,,Shpatën" si studenti më i mirë ndërkombëtar, dëshmoi aftësi profesionale edhe në garën me prestigjioze ,,Cambrian Patrol" ku zuri vendin e parë me njësitin e tij .



Të gjitha këto njohuri profesionale të fituara në Mbretërinë e Bashkuar ai, i zbatoi me sukses në praktikë në Batalionin e Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) ku vepron. Togeri Ismail Hoxha kësaj radhe do të jetë në cilësinë e instruktorit të FSK-së, në Britani të Madhe. Togeri Hoxha, në Mbretërinë e Bashkuar, gjegjësisht në Skoci, do të kryejë detyrën e instruktorit për t'i mësuar kadetët britanikë. Ai gjithashtu do të qëndrojë edhe në Uells, në cilësinë e instruktorit në Kursin Luftarak për Komandant të Togut. Shumë rrallë ndodhë të zgjedhën si instruktor nga personeli ndërkombëtar për të udhëzuar dhe trajnuar oficerët britanikë. Kjo është një kredi e madhe për togerin Ismajl Hoxha dhe FSK-në.

Ministri Rrustem Berisha priti ambasadorin Qemal Minxhozi dhe atasheun ushtarak kolonel Ahmet Leka



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, priti sot (12.01.2018) në takim zyrtar ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Prishtinë, z. Qemal Minxhozi dhe atasheun ushtarak të Republikës së Shqipërisë, kolonelin Ahmet Leka i akredituar atashe rezident në Republikën e Kosovës. Ministri Berisha, me këtë rast, e njoftoi ambasadorin Minxhozi, me të arriturat e përgjithshme të MFSK-së dhe FSK-së, si dhe e falënderoi për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu ministri Berisha foli edhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Ministri Berisha me ambasadorin Minxhozi bisedoi edhe për bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e shkollimit dhe të trajnimeve për pjesëtarët e FSK-së në Republikën e Shqipërisë dhe pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Kosovë, duke u ndërlidhur me Qendrën e trajnimit të Kërkim-Shpëtimit në Pomozotin dhe Qendrën Universitare të FSK-së, ku studiojnë edhe kadetë nga Republika e Shqipërisë, si dhe biseduan edhe për zgjerimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Ndërsa atasheut ushtarak, kolonelit Ahmet Leka i uroi detyrën e re duke i afruar bashkëpunim nga ana e tij dhe MFSK-së. Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Minxhozi, me këtë rast falënderoi ministrin Berisha, komandantin e FSK-së dhe FSK-në, për intervenimin e shpejtë në Republikën e Shqipërisë, pas vërshimeve duke iu dalë në ndihmë qytetarëve të Shqipërisë. Ai theksoi se ky bashkëpunim është në interes jo vetëm të dyja shteteve, por edhe në interes të paqes dhe sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Komandanti i FSK-së në ceremoninë e ndërrimit të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 18.01.2018, mori pjesë në ceremoninë e ndërrimit të komandantit të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, që u mbajt në Wisbaden të Gjermanisë, me ç'rast detyrën e komandantit e mori gjenerallejtënant Christofer G. Cavoli. Gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast takoi komandantin e SHBA-ve për Evropë, gjeneralin Curtis Scaparrotti. Gjeneral Rama gjatë takimit e njoftoi gjeneralin Scaparrotti me zhvillimet e fundit në Kosovë, si dhe me progresin e përgjithshëm të FSK-së duke u ndalur me theks të veçantë në integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në FSK. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, e siguroi gjeneralin Scaparrotti dhe partnerët tanë strategjikë se ,,FSK-ja do të vazhdojë të jetë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallime etnike dhe e përkushtuar për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë me KFOR-in dhe të gjitha institucionet tjera të sigurisë".

Në këtë ceremoni, komandantit i FSK-së shoqërohej nga atasheu amerikan në Kosovë, koloneli Jeffrey Fischer.

Obelisk për ushtarët e NATO-s të rënë në Kosovë

Sot (26.01.2018) në ambientet e Komunës së Prishtinës, ministri i Forcës e Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha u prit në një takim pune nga kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti. Në këtë takim ministri Berisha e ka uruar kryetarin Ahmeti, për rizgjedhjen në krye të Komunës së Prishtinës. Nga ana e tij, kryetari i Komunës së Prishtinës z. Ahmeti, shprehu kënaqësinë për vizitën e ministrit Berisha dhe vlerësoi pozitivisht bashkëpunimin në mes MFSK-së, përkatësisht FSK-së, me Komunën e Prishtinës. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi i punëve lidhur me iniciativën e ministrit Rrustem Berisha për ndërtimin e Obeliskut(Përmendores), për ushtarët e NATO-s të rënë në Kosovë në vitin 1999. Kjo iniciativë i është paraqitur Qeverisë së Kosovës nga ministri FSK-së, z. Berisha, e cila e ka nxjerrë vendimin për ndërtimin e Obeliskut më 27.12.2017. Në takim, ministri i FSK-së, z. Berisha dhe kryetari i komunës, z. Ahmeti kanë biseduar për procedimin për gjetjen e lokacionit të përshtatshëm duke pasur në konsideratë rëndësinë e obeliskut, si dhe kriteret urbanistike të qytetit të Prishtinës.

FSK-ja pjesë e seminarit "Vlerësimi i pozitave të ndjeshme nga rreziku i dukurive korruptive"



Në kuadër të procesit të zbatimit të projektit " Ndërtimi i Integritetit të MFSK-së dhe FSK-së", në Vjenë më 12.01.2018, u mbajt takimi me temën "Vlerësimi i pozitave të ndjeshme nga rreziku i dukurive korruptive", organizuar nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (Centre for Integrity in the Defence Sector- CIDS) e Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë.

Në këtë takim morën pjesë: Ministria për FSK-në, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama; përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes së Bosnjës dhe Hercegovinës.

Gjithashtu, në këtë takim ishin të pranishëm edhe përfaqësuesi nga CIDS z. Sven Eriksen, eksperti i fushës përkatëse nga Kosova, z. Florian Qehaja si dhe ekspertët rajonalë.

Nga ana e tij, zyrtari i lartë nga Ministria e Mbrojtjes së Bosnjës dhe Hercegovinës, prezantoi politikën përkatëse që zhvillohet në Ministrinë e tyre respektivisht "Rregulloren për vlerësimin e pozitave të ndjeshme nga rreziku i dukurive korruptive".

Përveç diskutimeve rreth rregullores në përgjithësi dhe metodologjisë së vlerësimit në veçanti, debati u zhvillua edhe në funksion të hartimit të politikave, procedurave të duhura dhe akteve normative të nevojshme për ngritjen e integritetit në institucionet tona të nivel të ministrive dhe forcave. Pastaj u diskutua edhe për implementimin e planeve të integritetit me masat dhe veprimet konkrete në funksion të parandalimit, eliminimit dhe reduktimit të dukurive korruptive dhe në përgjithësi atyre negative të cilat cenojnë funksionalitetin e ministrive dhe operacionalitetin e forcave tona.

Në përmbyllje të takimit me përfaqësues nga Bosnja e Hercegovina u diskutua për hapat e ardhshëm në zgjerimin e bashkëpunimit ndërministror dhe shkëmbimit të përvojave në fusha respektive në mes të MFSK-së /FSK-së dhe MM të BeH.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri dhe komandanti i FSK-së dekoruan oficeren e Gardës Kombëtare të Ajovës





Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) Rrustem Berisha dhe komandantit i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 24.01.2018, nderuan me mirënjohje dhe dekoruan me medalje major Jodi Marti, Oficer për Marrëdhënie Bilaterale pranë zyrës së ODC-s, pas përfundimit të suksesshëm të detyrës së saj në MFSK. Ministri Berisha e falënderoi major Marti për punën dhe angazhimin e saj dyvjeçarë në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe çmoi përkushtimin e saj në ngritjen e profesionalizmit të pjesëtarëve të FSK-së, ndikimin e saj në donacionet që i janë dhënë FSK-së, si dhe në avancimin e bashkëpunimit me Ajovën.

"Takohemi sot në shenjë respekti të major Martit, për kontributin dhe mbështetjen e saj për FSK-në në të gjitha fushat si dhe në thellimin e bashkëpunimit të FSK-së me SHBA-të dhe konkretisht me Gardën Kombëtare të Ajovës. Faleminderit major Jodi Marti për këtë bashkëpunim dhe për mbështetjen tuaj, kurse pasardhësit tuaj i uroj mirëseardhje dhe vazhdim të bashkëpunimit dhe sigurisht avancimin e tij",-u shpreh ministri Berisha.

Gjeneral Rama në fjalën e tij tha se qëllimi i këtij koktej ka qenë falënderimi ynë për punën dhe kontributin e major Jodi Martit për Kosovën dhe veçanërisht për FSK-në. Edhe motoja "All of Kosova all of Ajova" (e tëra e Kosovës e tëra e Ajovës) nënkupton që gjithçka që ka të bëjë me Kosovën ka të bëjë edhe me Ajovën. "Bashkëpunimi dypalësh më i mirë që kemi është ai me Ajovën, falë punës së palodhshme të oficerëve amerikanë ku pjesë e tyre pa dyshim është edhe major Jodi. Faleminderit Jodi. Suksese në të ardhmen. Ju jeni pjesë e historisë sonë",-u shpreh gjeneral Rama, duke përmendur po ashtu edhe bashkëpunimin jo vetëm në fushën e sigurisë por edhe në fusha të tjera. Gjeneral Rama i ndau major Jodi Martit "medaljen për shërbim vetëmohues".

Major Jodi Marti u shpreh mjaft e kënaqur për gjithë organizimin që ministri dhe komandanti kishin përgatitur për të. Ajo nënvizoi se çelësi i këtij bashkëpunimi të mirë është interesimi i vazhdueshëm për të punuar së bashku. Major Marti theksoi se nga të gjitha bashkëpunimet tjera të SHBA-së me vendet tjera, bashkëpunimi mes Ajovës dhe FSK-së është shembulli më i mirë. "Ju falënderoj të gjithëve për këtë organizim. Dy vjet shkuan shpejt, por kemi arritur shumëçka brenda kësaj kohe. Jam pjesë e historisë suaj dhe shpresoj gjatë kësaj kohe sa kam shërbyer këtu njerëzit të thonë që gjërat në FSK janë më mirë se vitet e kaluara",- përfundoi Jodi.

Ministri Berisha priti ekspertin nga Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë, z Eriksen



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha prit sot (31.01.2018) në takim, zotëri Svein Eriksen nga Ministria e Mbrojtjes së Mbretërisë së Norvegjisë. Në takim u bisedua për bashkëpunimin ndërmjet dy ministrive, që ka filluar prej vitit 2012 si dhe për rezultatet e këtij bashkëpunimi, sidomos në hartimin e Planit të Integritetit për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministri Berisha dhe eksperti norvegjez z.Eriksen gjithashtu shprehen gatishmërinë që bashkëpunimi të vazhdojë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes duke identifikuar me kujdes fushat që Ministria e FSK-së dhe FSK-ja do t'i konsideronin me prioritet, në të cilat do të fokusohej mbështetja nga Norvegjia.

Në takim morën pjesë edhe shefi i kabinetit të ministrit, zotëri Jashar Ramadani si dhe drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, zotëri Florian Qehaja.

Një delegacion i Komandës së SHBA-ve vizitoi Qendrën Koordinuese për Deminim të FSK-së



Një delegacion nga Komanda e SHBA-ve për Evropë, udhëhequr nga koloneli Chuck Crosby dhe kapiteni Mark Hall, më 22.01.2018, qëndroi për vizitë në Qendrën Koordinuese për Deminim në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Delegacioni u prit nga drejtori i kësaj qendre z. Ahmet Sallova dhe zyrtari i lartë Agron Haziri. Me këtë rast, drejtori Sallova i njoftoi mysafirët për progresin e arritur në pastrimin e zonave të prekura nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera në Republikën e Kosovës, me resurset e tanishme në dispozicion për pastrim, si dhe me planet për pastrimin e zonave të mbetura në të ardhmen.

Në takim gjithashtu u diskutua edhe për sfidat dhe për mundësitë e zhvillimit të mëtejmë të operacioneve të deminimit.

MFSK-ja dhe KHAIA-ja nënshkruajnë Memorandum bashkëpunimi



Në Zyrën e Kryeministrit, të premten (26.01.2018), është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK) dhe Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Memorandumi është nënshkruar nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Dr. Shkelzen Sylaj dhe kryesues i KHAIA-së, z. Mirsim Beqiri. Ky memorandum bashkëpunimi rregullon mënyrën e afrimit të mbështetjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës për KHAIA-në, në rast të ndonjë aksidenti ajror ose hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Mbështetja do të ofrohet nga njësitë e kërkim-shpëtimit të FSK-së, me qëllim të gjetjes së personave të zhdukur, kutive të zeza si dhe materialeve të tjera, objekt i hetimeve dhe kërkimeve të KHAIA-së. Gjithashtu FSK-ja do të mbështesë KHAIA-në në transportin e mbetjeve në rast të një aksidenti të fluturakeve dhe trenave nga vendi i transportit deri në lokacionin e caktuar nga Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

Kadetët e FSK-së realizojnë tra



Kadetët e Qendrës për Studime Universitare kanë mbajtur trajnimin semestral për vitin 2018. Sipas planifikimit paraprak kadetët e QSU-së kanë qenë të ndarë në dy grupe:

Grupi i parë: Kadetët e vitit të katërt-gjenerata 2018, kanë zhvilluar vizita nëpër njësitet e FSK-së për t`u njoftuar më për së afërmi me misionin, strukturën, detyrat, trajnimet, organizimin dhe funksionimin e këtyre njësive. Kjo vizitë nëpër njësitet e FSK-së ishte shumë e mirëpritur dhe frytdhënëse për kadetët të cilën janë në prag të diplomimit dhe gradimit si oficerë të Forcës. Grupi i dytë: Kanë qenë të përfshirë kadetët e tri gjeneratave tjera, të cilët kanë zbatuar në praktikë ato njohuri që i kanë mësuar gjatë semestrit të kaluar të vitit akademik 2016/2017 në QSU. Bazuar në plan-programin e QSU-së, kadetët janë trajnuar dhe vlerësuar sipas nivelit të tyre; kadetët e vitit të parë janë trajnuar dhe testuar kryesisht në lëvizjet taktike dhe operacionet në nivel ekipi; ata të vitit të dytë janë avancuar deri në nivel skuadre; ndërsa, kadetët e vitit të tretë janë trajnuar dhe vlerësuar kryesisht në punimin e Urdhrave Operacionalë përmes zbatimit të Procedurës së Udhëheqjes

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes zhvillohen kurse profesionale



Sot (16.01.2018) në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS), të FSK-së në Ferizaj, u mbajt ceremonia e fillimit të mbajtjes së kurseve për pjesëtarët e FSK-së, për vitin shkollor 2018.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm: zëvendësministri Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gezim Hazrolli, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Janos Csombok, atasheu ushtarak i SHBA-ve kolonel Jeffrey Fischer dhe oficerë të lartë dhe pjesëtarë të FSK-së.

Në emër të ministrit Rrustem Berisha, ceremoninë e përshëndeti zëvendësministri Burim Ramadani i cili përgëzoi FSK-në, për të arriturat e përgjithshme gjatë vitit 2017, duke shprehur përkushtimin për avancimin, ngritjen, trajnimin dhe profesionalizimin e institucioneve të sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës. „Ngjarja e sotme është një hap i madh për dëshminë e suksesit të FSK-së. Ministria jonë është në mbështetje të plotë të secilës fushë, duke përfshirë mbështetjen për Komandën e Trajnimeve dhe Doktrinës në avancimin e punës së saj profesionale, programit të trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve", shtoi zëvendësministri Ramadani. Ai në vazhdim të fjalës së tij tha se „Qeveria e Kosovës dhe MFSK-ja po punojnë me përkushtim në përmbylljen e suksesshme të procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, duke ofruar kështu një mundësi me vlerë të veçantë për sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama theksoi se kjo ceremoni shënon fillimin e trajnimeve për vitin 2018. Mund t'ju them, tha ai, se si komandant i FSK-së jam i kënaqur me planifikimet që janë bërë. Gjeneral Rama duke iu drejtuar pjesëtarëve të FSK-së, shtoi se: "motivimi, gatishmëria dhe disiplina për të marrë njohuri të reja duhet të jetë motivi shtesë për arritje të reja individuale".

Komandanti i FSK-së, duke folur për detyrat dhe sidat tha se "zhvillimi i FSK-së është në një fazë thelbësore për ardhmen e Republikës e Kosovës. Ju e dini që ky vit është përcaktues për ndryshimet e shumë pritura për transformimin e saj në Forca të Armatosura".

Ndërsa komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjatë fjalës së tij, tha: "Për të realizuar misionin tonë, ne zhvillojmë kurse të ndryshme profesionale me anë të të cilave synojmë aftësimin e pjesëtarëve tanë, duke ndikuar në ngritjen e një force profesionale, të gatshme të përballet me sfidat e kohës".

Ai njoftoi se gjatë vitit 2018, në KDS, do të realizohen 35 kurse me gjithsej 74 gjenerata të kursantëve pjesëmarrës nga të gjitha njësitë e FSK-së, të cilat do të zhvillohen në: Qendrën për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve, Qendrën e Stërvitjes Specialistike, Qendrën e Stërvitjes Kolektive, Qendrën e Stërvitjes Bazike dhe në Qendrën për Studime Universitare".

Në fund gjeneral Cikaqi foli edhe për bashkëpunimin intensiv dhe profesional që ka KDS-ja me partnerët ndërkombëtarë.





jnimin semestral për vitin 2018

së Trupave (PUT), në nivel togu. Ky trajnim është realizuar në poligonet trajnuese të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, në kushte të rënduara atmosferike dhe temperatura të ulëta, me qëllim të përgatitjes sa më të mirë fizike, mentale dhe profesionale të Trupës së Kadetëve të QSU-së. Ata u sfiduan në zhvillimin e operacioneve të ndryshme ofensive, defensive, operacione të mbështetjes së paqes duke u testuar në aftësitë e tyre të marrjes së vendimeve të drejta dhe të shpejta në ambiente stresuese dhe nën presion të kohës.

Bashkëpunimi me partnerët tanë nga GLSH-L, Bondsteel edhe këtë herë ishte i shkëlqyer. Ata ofruan bashkëpunim në planifikimin dhe realizimin praktik të evakuimit mjekësor (MEDEVAC) me helikopter. Kjo ishte një përvojë e re dhe shumë e mirëpritur për shumicën e kadetëve të QSU-së. Për t`u njoftuar më për së afërmi me realizimin e aktiviteteve gjatë trajnimit semestral kadetët janë vizituar nga ZVKOMKDS kolonel Irfete SPAHIU e cila u nda e kënaqur me punën, aktivitetin dhe motivimin e tyre dhe stafin e QSU-së.?



Ministri dhe komandanti bëjnë homazhe në nderim të martirëve dhe dëshmorëve në Reçak



Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me stafin e lartë të MFSK/FSK-së, sot morën pjesë në shënimin e 19-të vjetorit të masakrës së Reçakut. Në Kompleksin Përkujtimor (15.01.2018) ata vendosen lule dhe bënë homazhe te varrezat duke nderuar të gjithë martirët dhe të rënët për Liri. Ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë vizitës në Kompleksin Përkujtimor takuan qytetarët e pranishëm të Raçakut, të cilëve ju shprehën ngushëllimet dhe njëkohësisht edhe krenarinë për familjarët e tyre, duke çmuar lartë sakrificën e të rënëve të Reçakut.

Ministri Berisha ndër të tjera tha se „Liria që ne po e gëzojmë sot dhe Pavarësia e Kosovës i kanë rrënjët në gjakun e dëshmorëve, martirëve dhe të gjithë të rënëve për shtetin e pavarur të Kosovës".



Ministri dhe komandanti i FSK-së bëjnë homazhe te shtatorja e Zahir Pajazitit

Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me një delegacion të MFSK/FSK-së, sot (31.01.2018) në përvjetorin e 21-të të rënies së heronjve të kombit Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu, vendosën lule dhe bënë homazhe te shtatorja e Zahir Pajazitit, në sheshin që e mban emrin e tij, në qendër të Prishtinës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së, me këtë rast, nderuan veprën e heronjve të kombit, të cilët 21 vite më parë ranë në krye të detyrës ndaj Atdheut në fshatin Pestovë.

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha priti një delegacion të deputetëve nga radhët e komuniteteve

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), ministri Rrustem Berisha priti sot në vizitë një delegacion nga radhët e komuniteteve, të prirë nga Veton Berisha, deputet i Kuvendit të Kosovës, Bashkim Krasniqi zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Isa Osmani këshilltar i Kryeministrit dhe Arlind Zogaj pjesëtar i FSK-së.

Ministri Berisha ka falënderuar delegacionin për vizitën e parë të realizuar në Ministrinë e FSK-së dhe njëherësh i njoftoi ata për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, aktivitetet e tanishme si dhe planet për zhvillimin e FSK-së dhe transformimin e saj në Forca të Armatosura të Kosovës.

Ministri Berisha, mysafirët i njoftoi edhe për misionin duke u shpreh se FSK-ja është një forcë profesionale dhe shumetnike që i përket gjithë popullit të Kosovës dhe është në shërbim të gjithë qytetarëve pa dallime etnie. Ai i njoftoi edhe me përfaqësimin e FSK-së, duke vënë theksin te pjesëtarët e komuniteteve egjiptian dhe ashkalinj, të cilët me përgjegjësi të madhe i kryejnë detyrat e përgjithshme dhe janë shembull i bashkëpunimit dhe mirësjelljes në radhët e FSK-së.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, z. Veton Berisha, në emër të delegacionit që përfaqësonte e ka falënderuar ministrin Berisha për pritjen si dhe e ka përgëzuar për punën dhe të arriturat e përgjithshme, duke u shprehur se është pro formimit të Forcave të Armatosura të Kosovës.

Gjatë takimit u bisedua edhe për mundësinë e përfshirjes së pjesëtarëve të komunitetit egjiptian dhe atij ashkali në radhët e FSK-së.



Shefi i Shtabit të KFOR-it vizitoi Qendrën Koordinuese për Deminim në MFSK



Sot (11.01.2018) në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) qëndroi për një vizitë zyrtare shefi i Shtabit të KFOR-it, gjeneral brigade Randy Powell, me bashkëpunëtorë. Ai u prit nga drejtori i Qendrës Koordinuese për Deminim, z. Ahmet Sallova dhe zyrtari i lartë Agron Haziri.

Me këtë rast, drejtori Sallova e falënderoi gjeneralin Powell për vizitën dhe përmes një prezantimi të shkurtër e njoftoi me progresin e arritur deri me tani në pastrimin e zonave të afektuara nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera në Republikën e Kosovës, me resurset e tanishme për pastrim, si dhe planet për pastrimin e zonave të mbetura në të ardhmen.

Gjatë takimit të dyja palët vlerësuan lart bashkëpunimin e deritashëm në mes të njësiteve të EOD-s të FSK-së dhe të njësiteve të EOD-s të KFOR-it, duke e konsideruar këtë bashkëpunim si mjaft të dobishëm sidomos gjatë ekzekutimeve të detyrave të EOD-së. Po ashtu është diskutuar mundësia e organizimit të një ushtrimi të përbashkët për evakuim mjekësor gjatë operacioneve të deminimit.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të KFOR-it, gjenerali Randy Powell u nda i kënaqur me progresin e arritur deri më tani në operacionet e deminimit, dhe njëherësh premtoi që KFOR-i do të vazhdojë me përkrahjen e nevojshme për mbështetjen e njësive të FSK-së dhe organizatave tjera të përfshira në pastrimin e zonave të minuara.

Interesim i madh për dhurim të gjakut në FSK

Bazuar në planin e veprimit për vitin 2018 të Drejtorisë për Politika dhe Plane, përkatësisht Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Departamentit të Mjekësisë në MFSK, në koordinim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK), sot në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës filloi aksioni humanitar për dhurimin e gjakut. Këtij aksioni iu përgjigjen një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së dhe stafit civil të Ministrisë për FSK-në.

FSK-ja tashmë ka një traditë të organizimit të aksioneve humanitare për dhurimin vullnetar të gjakut, me moton ,,një pikë gjak për shpëtimin e një jete".

Ndër të parët që iu përgjigjen këtij aksioni humanitar ishte zëvendësministri i MFSK-së, z. Burim Ramadani dhe shumë oficerë të lartë dhe stafit civil të Ministrisë. Zëvendësministri Ramadani me këtë rast tha:,, FSK-ja gjithmonë i përgjigjet jo vetëm aksioneve të organizuara për dhurimin e gjakut, por edhe sa herë paraqitet nevoja dhe bëhen thirrje individuale për ndihmë përfshirë edhe dhurimin e gjakut".

Ndërsa, dr. Bukurije Zhupi nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës, tha:,, Pjesëtarët e FSK-së janë bërë një shembull i mirë për të ndihmuar qytetarët e Kosovës dhe për ngritjen e vetëdijes te qytetarët që t'i përgjigjen aksionit humanitar për dhurimin e gjakut dhe aksioneve të ngjashme humanitare". Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut në kuadër të FSK-së realizohet në dy faza brenda vitit.

Vlen të theksohet se që në ditën e parë, këtij aksioni i janë përgjigjur 50 pjesëtarë të MFSK-së. Aksioni do të vazhdojë nesër në kazermën ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore dhe do të zgjasë deri më 22 shkurt 2018, në të gjitha njësitet dhe kazermat e FSK-së.



Gjeneral brigade Kirk Van Pelt nga Garda Kombëtare e Arkansasit viziton KDS-në

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes(KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjeneral brigade Enver Cikaqi në ambientet e Kazermës ,,Skënderbeu'' në Ferizaj, më 30 janar 2018, priti në një takim miqësor ndihmës asistentin e gjeneralit të Gardës Kombëtare të Arkansasit, gjeneral brigade Kirk Van Pelt të shoqëruar nga komandanti i kampit ushtarak amerikan ,,Bondstill'', kolonel Michael Spraggins.

Me këtë rast, gjeneral Cikaqi e njoftoi delegacionin amerikan me misionin, detyrat dhe të arriturat e KDS-së, si dhe bashkëpunimin e deritashëm me ushtrinë amerikane me theks të veçantë me ushtarët amerikanë në Bondstill.

Gjeneral Cikaqi vlerësoi lart përkushtimin dhe ndihmën e SHBA-së në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, ndihmën që i kanë dhënë KDS-së në përgatitjen dhe realizimin e stërvitjeve dhe certifikimin e instruktorëve, adaptimit të programeve për kurset që realizohen në KDS prej vitit 2009 e deri më sot, si dhe shprehu besimin dhe gatishmërinë e tij që ky bashkëpunim



të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndërsa, gjenerali Pelt, pasi u njoh nga afër me KDS-në, punën, angazhimin dhe të arriturat e pjesëtarëve të FSK-së tha: ,,Ndjehem i lumtur kur shoh se ju keni arritur një standard të lartë të përmbushjes së misionit, dhe më vjen mirë kur dëgjoj se ushtarakët tanë kanë kontribuar për të ndërtuar një institucion të përgatitur siç është Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, me standarde dhe kapacitete të larta''.

Në fund gjeneralët Cikaqi dhe Pelt u shprehën se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mes FSK-së dhe ushtrisë amerikane me qëllim të ngritjes së aftësive dhe profesionalizmit të pjesëtarëve të FSK-së.

Oficeri i lartë amerikan, gjeneral brigade Kirk E. Van Pelt ka vizituar Bondstillin si dhe ka shprehur interesimin për të vizituar KDS-në.

Vizita është realizuar në kuadër të bashkëpunimit në mes të KDS-së/FSK-së me Grupin Shumëkombësh Luftarak Lindje (Bondstill).

FSK-ja evakuon nxënës nga Prevalla



Njësia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza e FSK-së, pas vlerësimit dhe rishikimit të zonës në Brezovicë për të verifikuar se mos ka të izoluar nga bllokimi i rrugës nga dëbora, ka marrë një informacion plotësues se një grup i nxënësve kanë udhëtuar këmbë në drejtim të Prevallës.

Rreth orës 22:00 janë evidentuar 19 nxënës nga Gjakova. Këta nxënës të ngelur në rrugë dhe dëborë, janë ndihmuar nga njësia e FSK-së e cila ka bërë transportimin e tyre nga Prevalla në Gjakovë.

Grupi i nxënësve janë ribashkuar me familjet e tyre në Gjakovë rreth orës 03:00 të mëngjesit.

Në këtë operacion kanë qenë të angazhuar pjesëtarët e Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza dhe të Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së.

Policia e FSK-së realizon trajnim në Bondsteel



Në kuadër të bashkëpunimit mes FSK-së dhe KFOR-it, për dy javë, në kampin Bondsteel, Policia e Forcës së Sigurisë së Kosovës (PFK) ka realizuar trajnimin ,,Zbatimi i Ligjit në Policinë Ushtarake". Ky trajnim është realizuar nga instruktorë të Policisë Ushtarake Amerikane. Trajnimi ka filluar më 15 janar dhe ka përfunduar dje më 30. 01.2018. Trajnimi është fokusuar në temat: Reagimi në aksident të trafikut dhe hetimi i aksidentit; Ndalesat në trafik; Ndalesat në trafik me rrezikshmëri të lartë etj. Ky trajnim si dhe trajnimet tjera që janë realizuar nga instruktorët e Ushtrisë Amerikane janë rezultat i bashkëpunimit në mes dy vendeve.

Në fund të trajnimit, (31.01.20`18) instruktorët amerikanë u pritën nga zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i cili i falënderoi për ndihmën e dhënë në ngritjen profesionale për pjesëtarët e FSK-së. Me këtë rast gjenerali Gëzim Hazrolli ndau mirënjohje për instruktorët e angazhuar në këtë trajnim.

FSK-ja përfundoi operacionin e kërkim-shpëtimit në lumin Erenik

Sot, (06.01.2018) rreth orës 11.30, Njësiti i specializuar i Kërkim-Shpëtimit në Ujëra i FSK-së, arriti ta gjejë trupin e pajetë të 82 vjeçarit, Mustafë Haxhisë, i cili kishte rënë në lumin Erenik të Gjakovës.

Ekipet e Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, pas marrjes së informacionit se një person ishte zhdukur në ujërat e lumit Erenik të Gjakovës, u angazhuan në kërkimin e trupit të tij dhe pas një kërkimi përgjatë rrjedhës së lumit në gjatësi prej 9 km, arritën ta gjejnë trupin e pajetë të të ndjerit, në kilometrin e gjashtë të rrjedhës së Lumit Erenik.

Trupi i pajetë iu dorëzua Policisë së Kosovës.

Në këtë operacion ishin të angazhuar edhe Drejtoria për Emergjenca e Kuvendit Komunal të Gjakovës, Policia e Kosovës, një ekip mjekësor i emergjencës së spitalit të Gjakovës dhe zjarrfikësit e Gjakovës.



Xhenierët e FSK-së, gjatë këtij muaji, ngritën dy ura metalike-mobile; mbi lumen Sitnicë në Mitrovicë, dhe në fshatin Zëmblak të prefekturës së Korçës-Shqipëri.













FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 66 • 2 Mars 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

FSK-ja parakaloi në 10-vjetorin Pavarësisë së Kosovës

Në përvjetorin e dhjetë të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, sot (18.02.2018) në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë, u mbajt manifestimi qendror, ku parakaluan edhe kuadratet e njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës.

Në tribunë ishin të pranishëm ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Timothy Orr dhe zyrtarë të lartë të ministrisë dhe oficerë madhorë të FSK-së.



Manifestimi filloi me intonimin e Himnit shtetëror të Kosovës nga Orkestra frymore e FSK-së.

Më pas, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrrahman Rama, raportoi para presidentit Thaçi, për gatishmërinë e Forcave të Sigurisë së Kosovës për parakalim.

(vijon në faqen 4)

Ministri Rrustem Berisha priti asistentin e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve, Robert Karem

Ministri i FSK-së,Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 18.02.2018, pritën asistentin e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve, z. Robert Karem me bashkëpunëtorë.

Me këtë rast, ministri Berisha falënderoi SHBA-të për ndihmën e gjithanshme për FSK-në, si me angazhim të personelit, ashtu edhe për bashkëpunimin shumë intensiv dhe të gjithanshëm. Ky bashkëpunim kulmon sidomos me bashkëpunimin që ka FSK-ja me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ministri Berisha foli edhe për standardin e lartë që ka FSK-ja, përgatitjen profesionale si dhe angazhimet e shumta për të kryer me përkushtim detyrat në bazë të misionit aktual. Pas 19 vjet çlirim dhe 10 viteve të shpallje së pavarësisë, si dhe rekomandimeve të dala nga RSSSK, qytetarët dhe institucionet presin përfundimin e procesit të transformimit të FSK-së në FAK. Ky proces do të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese dhe në koordinim me partnerët strategjikë, dhe do të jetë shumë transparent. FAK-u nuk paraqet rrezik për askënd, sepse është forcë e gjithë qytetarëve dhe do të kontribuojë në rritjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Ministri foli për objektivat e ardhshëm; për ngritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve dhe rritjes së përfaqësimit gjinorë; strategjinë e integrimit të



komuniteteve jo shumicë; planin e integritetit si ministri; shkallën e integritetit si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, nga ana tij theksoi se; FSK-ja është forcë profesionale, me koncept perëndimor dhe e mbështetur në konceptet dhe doktrinën amerikane. Mbi arritjet në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar sidomos me shtetet me të cilat janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe.

Ai theksoi përfaqësimin e mirë në përqindje të komuniteteve pakicë; kryerjen me sukses të detyrave që dalin nga misioni aktual. Ndërkaq përgatitjet për transformim janë kryer në të gjitha drejtimet, janë bërë planifikimet e afatizuara dhe përgatitjet tjera të nevojshme.

Mysafiri nga SHBA-të, zoti Robert Karim shprehu kënaqësinë për pritjen duke u shprehur se ndjente kënaqësi të veçantë që ndodhet në vizitë në 10 vjetorin e festimit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ai foli po ashtu për interesimin e madh që SHBA-të i kushtojnë zhvillimeve në fushën e sigurisë në Ballkan dhe më gjerë. Me këtë rast ai vlerësoi lart përkushtimin që procesi i transformimit të FSK-së të jetë transparent dhe mbi baza kushtetuese dhe me hapa të koordinuar me SHBA-të dhe partnerët tjerë strategjikë.

Forca e Sigurisë së Kosovës më e besueshmja për qytetarët e Kosovës

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) më 1 shkurt 2018, bëri publikimin e edicionit të shtatë të Barometrit Kosovar të Sigurisë dhe sipas rezultateve doli që FSK-ja është institucioni më i besueshëm i sigurisë në vend. 78% e qytetarëve të vendit të anketuar e besojnë FSK-në. Besueshmëria nga viti i kaluar ka shënuar rritje në masën prej 11%. Kjo gjë ka ndikuar edhe në rritjen e besueshmërisë në veri të vendit tonë. Në konferencë ishin të pranishum edhe zëvendësministri Burim Ramadani dhe drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi si dhe përfaqësues nga Policia e Kosovës, shoqëria civile, mediat etj.

Pas publikimit të rezultateve, zv.ministri Ramadani u shpreh: "Profesionalizmi, diversiteti etnik, angazhimi i pakursyer për qytetarët, aktivitetet e shumta humanitare, mbështetja për autoritetet civile në nivel qendror e lokal, si dhe shumë faktorë të tjerë kanë bërë që Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) të ruajë primatin dhe të rrisë besueshmërinë e qytetarëve ndaj saj. Kjo është krenari për institucionin, pjesëtarët e saj, Kosovën në tërësi dhe partnerët mbështetës ndërkombëtarë".

Sipas Barometrit Kosovar të Sigurisë, Forca e Sigurisë së Kosovës, në anketimin e qytetarëve të Kosovës në fundin e vitit 2017, ka dalë e para me 78%, ndërsa sipas rajoneve ka dalë që qytetarët e rajonit të Mitrovicës, të pjesës jugore e besojnë më së shumti FSK-në, në shkallën 86%, ata të Prishtinës me 84% pasuar nga ata të Pejës e me radhë.

Ministri Rrustem Berisha e priti ministren e Mbrojtjes së Maqedonisë, znj. Radmilla Shekerinska

Me ceremoni zyrtare, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha, më 2 shkurt 2018, priti në vizitë, ministren e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, znj. Radmilla Shekerinska-Jankovska. Fillimisht të dy ministrat zhvilluan takim vetëm për vetëm dhe më pas u zhvillua takimi i përbashkët i të dy delegacioneve, me ç 'rast u bisedua për marrëdhëniet e mira dypalëshe, aktivitetet konkrete si dhe për vazhdimin e marrëdhënieve në të ardhmen.



Me këtë rast, ministri Berisha falënderoi ministren Shekerinska për bashkëpunimin e mirë dhe konkret me Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë, për gatishmërinë për zgjerimin e fushave të bashkëpunimit si dhe për shkëmbimet tjera në fushën e trajnimeve, shkollimeve si dhe ushtrimeve fushore.

Ministri Berisha konfirmoi aspiratën e Republikës së Kosovës për Anëtarësim në NATO dhe integrim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se marrëdhëniet e mira me vendet anëtare të NATO-s dhe vendet që aspirojnë për t'u anëtarësuar në NATO është prioritet i yni. Në kontekst të kësaj, ministri Berisha foli edhe për përgatitjet për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës(FAK) si Forcë e të gjithëve dhe për të gjithë qytetarët e vendit.

Nga ana e saj, ministrja e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë tha se Ministria që ajo drejton është e gatshme për kultivimin, zgjerimin dhe avancimin e bashkëpunimit shumë të frytshëm me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ajo tha se kapacitetet shkollore, trajnuese dhe stërvitore janë të gatshme dhe në dispozicion për aktivitete të përbashkëta.

Të dy ministrat, Berisha dhe Shekerinska, pas takimit, para gazetarëve, konfirmuan gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mbështetjen reciproke, bazuar mbi Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive, të dy vendeve tona. Me këtë rast, ministri Berisha theksoi se me ministren Shekerinska biseduan për bashkëpunimin e deritanishëm, i cili ka qenë shumë aktiv si dhe u akorduam që aktivitetet tona të vazhdojnë edhe në të ardhmen, bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit që kemi nënshkruar të dy ministritë. Rëndësi e veçantë tha ministri Berisha i është kushtuar përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, si dhe është bërë një hap më shumë edhe me hartimin e Strategjisë për integrim të komuniteteve ku aktualisht FSK-ja ka brenda strukturës së saj mbi 10%. ,,Në kuadër të kësaj është transformimi i FSK-së në FAK përmes ndryshimeve kushtetuese, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë faktorët politikë dhe përfaqësuesit politikë të komuniteteve, në koordinim të plotë me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe NATO-në'', përfundoi ministri Berisha. Ministrja Jankovska tha se marrëdhëniet e mira me FSK-në do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, duke thelluar këtë bashkëpunim edhe më tutje. Ajo përmendi edhe shkollimin ushtarak dhe programin e ri të NATO-s për shkollime ushtarake dhe, siç tha ajo, kur kadetët e vendeve tona shkollohen dhe bashkëpunojnë bashkë mirë tani, këtë frymë do ta bartin edhe në të ardhmen si ushtarakë. Ministrja Shekerinska tha gjithashtu se sipas planit të bashkëpunimit për këtë vit, ndërmjet dy ministrive ne do të marrim pjesë në ushtrimin ,,Shqiponja 6'' si dhe do ta shfrytëzojmë për stërvitje dhe trajnim edhe Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së. Ndërsa, sa i përket transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura ajo tha se përkrahin transformimin me ndryshime kushtetuese dhe shtoi: ,,Ne e përkrahim qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare se duhet të respektohen të gjitha procedurat, situata politike dhe të gjitha situatat e ndjeshme në rajon''.

Gjatë vizitës në Francë

Ministri Rrustem Berisha u prit nga Sekretarja e Shtetit të Ministrisë së Armatave të Francës, znj. Geneviève Darrieussecq



Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, më 14 shkurt 2018, u prit në një takim pune në Paris, nga Sekretarja e Shtetit pranë Ministrisë së Armatave të Francës, znj. Geneviève Darrieussecq.

Në takim u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërmjet dy vendeve dhe për bashkëpunimin bilateral në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Ministri Berisha e njoftoi ministren franceze për të arriturat dhe synimet e FSK-së.

Znj. Darrieussecq e përgëzoi ministrin për sukseset, sidomos në integrimin e komuniteteve jo shumicë. Franca është partner i rëndësishëm i Kosovës dhe vizita e ministrit Berisha bëhet në prag të shënimit të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovë, për t'i shprehur mirënjohje Francës për kontributin e saj në rrugëtimin e Kosovës.

Ministri i FSK-së, z. Rrustem Berisha zhvilloi takime pune me ambasadorë të akredituar në Prishtinë





Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, gjatë muajit shkurt, priti dhe zhvilloi takime me ambasadorin e Çekisë, z. IvoSilhavy, të Bullgarisë, z. NedialtchoDimitrovDantchev, të Kanadasë, z. DanielMaksymiuk dhe ambasadoren e Finlandës, znj. PiaStjernvall

Ministri Berisha, gjatë takimeve zyrtare i ka falënderuar ambasadorët dhe shtet e tyre, që përfaqësojnë ata, për përkrahjen dhe ndihmat për Kosovën dhe FSK-në, si dhe kanë biseduar edhe për mundësinë e zhvillimit dhe avancimit të mëtejmë të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe në fushat tjera me interes për të dyja vendet. Gjithashtu, ministri Berisha i ka njoftuar ambasadorët edhe me zhvillimet e përgjithshme të FSK-së; arritjet dhe sukseset si brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal, bashkëpunimin me NATO-n, KFOR-in dhe NLAT-in (Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës për FSK-në), si dhe me zhvillimin e procesit të transformimit të FSK-së.





FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama raportoi para Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të FSK-së



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, raporti më 07 shkurt 2018, para Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për vitin 2017. Takimin e hapi kryetari i këtij komisioni, z. Haxhi Shala, i cili falënderoi komandantin e FSK-së, gjeneralin Rrahman Rama, për gatishmërinë për të raportuar para komisioni për të arriturat e FSK-së, për vitin 2017. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në prezantimin e raportit përmbledhës para anëtarëve të këtij komisioni, tha: ,,Duke u bazuar në objektivat e Ministrit dhe prioritetet e Komandantit të FSK-së, të dhëna në Direktivën për vitin 2017, si dhe në Planin Operativ të aktiviteteve dhe stërvitjeve, FSK-ja ka përfunduar vitin kalendarik 2017, dhe në bazë të rezultateve që kemi arritur në të gjitha fushat, mund të konkludojmë se ky vit e ka përcjellë FSK-në me mjaft suksese të realizuara si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Këto suksese janë arritur falë përkushtimit dhe angazhimit profesional të pjesëtarëve të FSK-së, në të gjitha nivelet". Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama më tej tha se në harmoni me udhëzimet e Ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Komandanti i FSK-së ka nxjerrë objektivat/prioritetet e tij për vitin 2017, siç janë: Mirëmbajtja e Gatishmërisë Operacionale, Zhvillimi i Forcës, Menaxhimi i Forcës, Mbështetja e Forcës dhe Ndërtimi i Partneritetit. Më tej, gjeneral Rama tha se gjatë këtij viti si brenda vendit dhe jashtë vendit janë realizuar shumë kurse profesionale specialistike individuale dhe kolektive të cilat po zhvillohen edhe në akademitë më prestigjioze të vendeve partnere si: Akademinë Ushtarake West Point në SHBA, Akademinë Ushtarake në Britani të Madhe, akademitë në Shqipëri, në Turqi, në Kroaci, në Maqedoni etj. Komandanti i FSK-së gjithashtu i njoftoi anëtarët e Komisionit Parlamentar edhe për aktivitet e njësiteve profesionale duke u ndalur në operacionet e deminimit, për pastrimin e fushave të minuara në nivel vendi, operacionet e kërkim-shpëtimit të helmeve kimike, operacionet mbështetëse humanitare në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës. Një rendësi të veçantë komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i kushtoi edhe ndërtimit të partneritetit me vendet anëtare të NATO-s , me KFOR-in, SHBA-të, e sidomos me Gardën Kombëtare të Ajovës, duke thënë se kemi realizuar qindra trajnime të përbashkëta jo vetëm në kuadër të FSK-së, por edhe në Ajova. Gjenerali Rrahman Rama, në kuadër të raportimit foli edhe për përgatitjet e përgjithshme që janë bërë për transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës. Shumë nga deputetët e Komisionit Parlamentar të Kosovës, në fjalën e tyre përgëzuan komandantin për arritjet e përgjithshme si dhe parashtruan pyetje të shumta që kishin të bënin me transformonin e FSK-së, me trajnimet, ushtrimet, shkollimet si dhe përqindjen e përgjithshme të pjesëtarëve të FSK-së.

Togeri Albert Asllani shpallet oficeri më i mirë ndërkombëtarë në kursin "Kapiten të karrierës" në SHBA



Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, togeri Albert Asllani, pas një trajnimi gjashtëmujor në shkollën ushtarake ,,United States Army Cyber Center of Excellence" në Fort Gordon të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) u nderua me çmimin "Colonel Alan C. Dexter, OBE, Award".

Këtë çmim e marrin studentët e dalluar të cilët tregojnë arritje të larta akademike si dhe profesionalizëm dhe lidership gjatë studimeve. Çmimi "Colonel Alan C. Dexter, OBE, Award" për Toger Albert Asllanin është edhe një dëshmi se Forca e Sigurisë së Kosovës është në rrugë të duhur sa i përket ngritjes profesionale të pjesëtarëve të saj, dhe se ky kualitet profesional është duke u dëshmuar edhe jashtë vendit si në: shkollime, trajnime, operacione, përfshirë këto edhe në akademitë më prestigjioze në botë.

Toger Albert Asllani pas kthimit nga SHBA-të do të vazhdojë shërbimin në Komandën e Forcave Tokësore (KFT) duke bartur përvojat e tij të fituara në këtë trajnim specialistik në të mirë të avancimit dhe ngritjes profesionale të FSK-së. Në këtë trajnim kanë marr pjesë oficerë nga shumë vende të botës. Ky është trajnim special për përgatitjen e oficerëve (Kapiten) të karrierës

Oficerë të FSK-së në Gjermani në seminarin „Udhëheqja me forcat ushtarake në demokraci"

Në kuadër të bashkëpunimit të shkëlqyer në mes të MFSK/FSK-së me Forcat e Armatosura të Gjermanisë dhe në vazhdimësi të realizimit të trajnimeve specialistike të përbashkëta, në Gjermani po qëndron një delegacion i MFSK/FSK-së, i udhëhequr nga gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione të MFSK-së.

Ky delegacion po merr pjesë në seminarin ,,Udhëheqja me forcat ushtarake në demokraci". Delegacioni i FSK-së është pritur nga zyrtarë të lartë të Bundesverit Gjerman, si dhe ka realizuar vizita të shumta në institucionet më të rëndësishme shtetërore të Gjermanisë. Delegacioni i FSK-së, është shoqëruar edhe nga atasheu i mbrojtjes i FSK-së në Republikën Federale të Gjermanisë, koloneli Xhavit Sadrijaj. Ky trajnim si dhe trajnimet tjera të shumta që po realizohen në Gjermani janë rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes Kosovës dhe Gjermanisë.



Gjenerali Enver Cikaqi mori pjesë në Konferencën evropiane të qendrave të trajnimit



Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe shefi i Operacioneve i Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Bashkim Shillova, kanë marrë pjesë në Konferencën evropiane të qendrave të trajnimit, që u mbajt në Grafenwoher të Gjermanisë, nga data 13-16.02.2018.

Në Konferencën evropiane të qendrave të trajnimit, në mesin e 28-të shteteve të ndryshme përfaqësuese, për herë të parë mori pjesë edhe Forca e Sigurisë së Kosovës.

Qëllim i organizimit dhe mbajtjes së kësaj konference ishte prezantimi i qendrave stërvitore dhe programeve të tyre të trajnimeve të cilat ato posedojnë. Ndërkaq, FSK-së, pjesëmarrja në këtë konferencë i ka krijuar mundësi të mira të njohjes me procedurat dhe programet e reja, të cilat në të ardhmen mund të aplikohen edhe në njësitë e saj.

Gjatë punimeve të konferencës një kontribut të veçantë e kanë dhënë ushtarakët nga vende të ndryshme, të cilët kanë diskutuar rreth kapaciteteve trajnuese dhe mundësive të përmirësimit të këtyre kapaciteteve me shkëmbimin e përvojave mes veti.

Gjeneral Enver Cikaqi është shprehur mjaft i kënaqur që ishte pjesë në këtë konferencë. Ai, përmes prezantimeve të shumta, pati mundësi të njihet me mënyrën e organizimit të qendrave tjera të trajnimit, funksionimin dhe dallimet e tyre, duke fituar kështu një përvojë të re, për ta praktikuar në të ardhmen në qendrën e trajnimit të FSK-së.

FSK-ja parakaloi në 10-vjeto







vijon nga ballina

Në përvjetorin e dhjetë të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, sot (18.02.2018) në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë, u mbajt manifestimi qendror, ku parakaluan edhe kuadratet e njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës. Në tribunë ishin të pranishëm ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Timothy Orr dhe zyrtarë të lartë të ministrisë dhe oficerë madhorë të FSK-së.

Manifestimi filloi me intonimin e Himnit shtetëror të Kosovës nga Orkestra frymore e FSK-së. Më pas, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrrahman Rama, raportoi para presidentit Thaçi, për gatishmërinë e Forcave të Sigurisë së Kosovës për parakalim.

Në fjalën e tij presidenti i Republikës së Kosovës, njëherësh edhe Komandant Suprem i FSK-së, Hashim Thaçi tha, se ,,bërja e këtij shteti dhe çlirimi i Kosovës ka bashkuar breza të tërë të cilët flijuan gjithçka për të bërë realitet shtetin sovran dhe demokratik, e cila para 10 viteve pikërisht, më 17 shkurt, ishte dhe do të mbetet ngjarja më e rëndësishme e popullit tonë. Herën e fundit kur kishim një parakalim të FSK-së, ishte para katër viteve. FSK-ja i kishte kryer të gjitha përgatitjet

Përurohet ura mobile e ndërtuar



Me ceremoni solemne u bë sot (15.02.2018) përurimi i urës mobile në fshatin Zëmblak të prefekturës së Korçës-Shqipëri, ndërtuar nga xhenierët e FSK-së. Në ceremoni të pranishëm ishin: ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, znj. Olta Xhaçka, zëvendësministri i MFSK-së, Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, shefi i Shtabit të FA të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ambasadori i Kosovës në Tiranë, Sylë Ukshini, atasheu i FSK-së, kolonel Enver Dugolli, oficerë të lartë të Ushtrisë së Shqipërisë dhe FSK-së, udhëheqës të Korçës dhe banorë të fshatrave përreth.

Në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe të ministrit Rrustem Berisha, zëvendësministri Burim Ramadani përgëzoi xhenierët e FSK-së dhe të Shqipërisë, për punën e shkëlqyeshme që kanë bërë në ngritjen e urës në fshatin Zëmblak të Korçës. Ai, veç tjerash tha se ,,jemi këtu për të dëshmuar gatishmërinë e Kosovës, institucioneve dhe FSK-së, që të ofrojmë ndihmë edhe për të tjerët, për Shqipërinë, për rajonin, si edhe më gjerë. Rruga e vetme që sjellë sukses dhe qëndrueshmëri për të gjithë ne, në rajon, është rruga e bashkëpunimit të plotë ndërshtetëror, rruga e mbështetjes së njeri-tjetrit, rruga e integrimit euroatlantik".

Ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, znj. Olta Xhaçka ka falënderuar Qeverinë e Kosovës dhe FSK-në, për ndihmën në sanimin e shpejtë të gjendjes pas vërshimeve në Shqipëri.,, FSK-ja dhe Qeveria e Kosovës na u përgjigjën që në

rin e Pavarësisë së Kosovës



për t'u transformuar në Forca të Armatosur të Kosovës, por fatkeqësisht ne si politikë e Kosovës nuk ishim në gjendje që t'i përcjellim si duhet në hapa Forcat e Armatosura të Kosovës, por tani gjërat kanë ndryshuar në Kosovë.

Si president i Kosovës jam i vendosur që shtetin e Kosovës ta bëjmë me ushtrinë e tij, dhe atë sa më shpejt që është e mundur". Presidenti Thaçi, më tej shtoi se "FSK-ja dhe Policia e Kosovës të cilat janë më të mirat në rajon, janë edhe fuqia e shtetit dhe garancia më e mirë e sigurisë dhe stabilitetit të vendit tonë, prandaj momenti i shumëpritur i zyrtarizmit të ushtrisë tonë është duke trokitur në derën e hapur.

Partnerët tanë strategjikë dhe NATO-ja janë duke e përkrahur plotësisht këtë proces të ushtrisë së Kosovës, sepse ajo do të jetë vetëm një vlerë tjetër e shtuar në shërbim të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë", tha presidenti i Kosovës Hashim Thaçi.

Pas fjalës së presidentit Thaçi, parakaluan kuadratet e FSK-së: Trupa Frymore, Njësia Ceremoniale dhe shtatë kuadratet e FSK-së dhe pesë kuadrate të Policisë së Kosovës.

Në manifestim ishin të pranishëm udhëheqësit shtetërorë të Kosovës, si dhe dhjetëra delegacione shtetërore, burrështetas, presidentë, kryeministra, ministra, mysafirë të shumtë nga trupa-diplomatike, KFOR-it, si dhe mijëra qytetarë të Kosovës dhe trojeve etnike.

Presidenti Hashim Thaçi dekoroi Agim Çekun me Medaljen Presidenciale



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, dje (22.02.2018) ka dekoruar, Agim Çekun, ish shefin e Shtabit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me Medaljen Presidenciale Jubilare, me rastin e shënimit të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Dekorimi është bërë me motivacionin për kontributin e tij të dhënë gjatë luftës për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës, si shef i Shtabit të UÇK-së, kryeministër i Kosovës dhe ish anëtar i Grupit Negociator në Procesin e Vjenës. Me këtë rast, Agim Çeku, ka thënë se "kjo dekoratë, për mua është edhe një obligim shtesë për të punuar në ndërtimin e institucioneve të Kosovës, e në veçanti për ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së, si dhe transformimin e saj, në Forcat e Armatosura të Kosovës". Presidenti Thaçi, me rastin e shënimit të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës ka dekoruar me medalje edhe personalitete tjera, të cilët kanë kontribuar në çlirimin e Kosovës.

Presidenti Hashim Thaçi dekoroi gjenerallejtënant Rrahman Ramën me Medaljen Presidenciale



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, më 27 shkurt 2018, e ka dekoruar komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënantët Rrahman Ramën, me Medaljen Presidenciale, me rastin e shënimit të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Dekorimi është bërë me motivacionin për kontributin e dhënë për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës. Medalja Presidenciale në 10 Vjetorin e Pavarësisë u jepet personave që kanë dhënë Kontribut për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.

nga FSK-ja në Korçë të Shqipërisë

minutat e para të emergjencës së dhjetorit, në përballimin e pasojave të saj. Ky kontribut këtu sot, për hir të së vërtetës, nuk është aspak i vogël, është një urë 54 metra, mjaft e konsiderueshme si në aspektin e ndërtimit ashtu edhe në konstruksionin teknik të saj, por edhe si kontribut i Qeverisë së Kosovës dhe FSK-së, për këtë zonë.

Përmes ndërtimit të kësaj ure keni lehtësuar komunikimin e 32 mijë banorëve me qendrat shëndetësore, me shkollat, me lëvizjen e lirë dhe komunikimin, me akset kryesore rrugore, që janë jashtëzakonisht të rëndësishme për jetën edhe për përditshmërinë e mijëra banorëve të kësaj zone". Znj. Xhaçka, në fund duke falënderuar edhe një herë Qeverinë e Kosovës dhe FSK-në, tha: ,,Jam shumë e lumtur që ky 10 vjetor i Pavarësisë së Kosovës na gjenë bashkë duke ndërtuar ura në frymën me të mirë të bashkëpunimit dhe duke ju ardhur në ndihmë qytetërove tanë".

Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pasi përgëzoi ushtarët për ngritjen e urës, shtoi se kjo është një dëshmi e mirë, dhe njëherësh kënaqësi për neve, që kemi pasur mundësi me kapacitetet që kemi, t'iu dalim në ndihmë qytetarëve dhe këtij komuniteti që t'iu mundësohet lëvizje e lehtësuar. Gjeneral Rama falënderoi Shtetin Shqiptar për përkrahjen dhe ndihmat e mëparshme dhe shtoi se ,,kjo ndihmë nuk krahasohet me përkrahjen që e kemi pasur nga Shteti Shqiptar, në kohërat më të vështira".

Në fund gjeneral Rama tha: ,Ne si Forcë jemi shumë profesionale dhe kjo urë si dhe të tjerat janë dëshmia më e mirë për ketë. Ne sadopak, ndihmën e juaj në kohërat më të vështira që e kemi pasur; nga ana e Shtetit Shqiptar dhe nga Forcat e Armatosura, po mundohemi sot ta kthejmë me shpresë që nuk do keni nevojë me për të tilla emergjenca. Por sido që të jetë, ne jemi në një botë reale dhe mund të kemi nevojë për njeri- tjetrin, prandaj me kapacitetet tona do të jemi të gatshëm në çdo kohë dhe në çdo moment t'ju përkrahim"

Batalioni i Xhenios i FSK-së, në Shqipëri, filloi ngritjen e urës mobile ,,Mabey Johnson" në fshatin Zëmblak të prefekturës së Korçës, më 3 shkurt dhe përfundoi ngritjen e saj në një afat rekord. Ura ka një gjatësi prej 54 metrash; është ngritur mbi lumin Devoll, dhe është nyje e rëndësishme për lëvizjen e përditshme të mijëra banorëve të fshatrave të prefekturës së Korçës .



Në përvjetorin e 10-të të shpalljës së Pavarësisë të Kosovës

Ministri dhe komandanti i FSK-së bënë homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz



Me rastin e festës jubilare, 10 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, sot ministri i FSK-së Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, të shoqëruar nga zyrtarë të lartë të ministrisë dhe oficerë madhorë të FSK-së, bënë homazhe tek varri i Komandantit legjendar të UÇK-së Adem Jashari, pjesëtarëve të familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve që pushojnë në Kompleksin Memorial në Prekaz. Me këtë rast ministri Berisha deklaroi: Ishim këtu për të nderuar veprën e lavdishme të Komandantit legjendar të UÇK-së Adem Jashari dhe sakrificën e madhe të familjes Jashari, si dhe për të nderuar të gjithë dëshmorët tjerë që kanë dhënë jetën për të gëzuar lirinë dhe për të festuar sot këtë ditë që e kemi, për të festuar 10- vjetorin e pavarësisë. Shfrytëzoj rastin që të gjithë qytetarëve të Kosovës të ju uroj 10- vjetorin e pavarësisë, pjesëtarëve të FSK-së dhe te gjithë atyre që kanë kontribuar për lirinë e Kosovës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së bënë homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova



Me rastin e festës jubilare, 10- vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, sot ministri i FSK-së Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, bënë homazhe tek varri i presidentit Ibrahim Rugova në Prishtinë. Me këtë rast ministri Berisha deklaroi: Në kudër të manifestimit të 10- vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, shënimin e kësaj dite ne e filluam me homazhet në Prekaz, vazhduam këtu me homazhet te varri i ish- presidentit

KFOR-i gjerman i dhuroi pajisje mjekësore FSK-së, në vlerë 140.000€

Në bazën e KFOR-it gjerman në Prizren, më 2 shkurt 2018, u mbajt ceremonia e dorëzim-pranimit të një kontingjenti të madh me material sanitar dhe pajisje tjera të Spitalit gjerman për FSK-në. Në ceremoni i pranishëm ishte edhe zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, shefi i Shtabit të KFOR-it, gjeneral brigade Lawrence Powell, dejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT-it), gjeneral brigade Ralf Hoffmann, komandanti i kontingjentit të 48-të gjerman të KFOR-it, nënkolonel Hans Jurgen Elsen dhe oficerë të KFOR-it dhe të FSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, pasi përshëndeti të pranishmit, falënderoi kontingjentin gjerman të KFOR-it, për mbështetjen e vazhdueshme për FSK-në, duke theksuar se "ne së bashku kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe koordinimin me kontingjentin gjerman për pranimin e këtij donacioni, që, neve na jep mundësi të kemi kushte dhe standarde më të mira, sa i përket kujdesit shëndetësor për pjesëtarët tanë. Bashkëpunimin që kemi filluar vite më parë do ta rrisim edhe më shumë në të ardhmen, që të jemi të pajisur sipas standardeve të NATO-s. Një falënderim të veçantë kam për kontingjentin gjerman dhe Ambasadën Gjermane në Kosovë, për dhurimin e këtij donacioni, i cili për FSK-në, ka një rol të veçantë".



Ndërsa, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT-it), për FSK-në, gjeneral brigade Ralf Hoffmann, në fjalën e tij shpalosi kontributin e Gjermanisë në Kosovë, që nga koha e luftës në Kosovë, duke theksuar se "deri më sot në Kosovë kanë shërbyer më shumë se 50.000 ushtarë gjermanë në kuadër të KFOR-it, të cilët kanë kontribuar në sigurinë e vendit dhe rimëkëmbjen e tij". Ai njoftoi të pranishmit se vitin e kaluar Ministri i FSK-së i është drejtuar Ministres Federale të Mbrojtjes së Gjermanisë, me kërkesë për



ndihmë në zhvillimin e kapaciteteve mjekësore të FSK-së, dhe ministrja Dr.Von Der Leyen i është përgjigjur pozitivisht kërkesës, duke i dhuruar FSK-së material dhe pajisje mjekësore, dhe theksoi se është nder për mua që t`i dorëzoj më shumë se 1200 artikuj mjekësorë komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama dhe drejtori i NLAT-it, gjenerali Ralf Hoffmann nënshkruan raportin e dorëzim–pranimit të donacionit nga kontingjenti gjerman i KFOR-it në Kosovë. Me këtë rast, u tha se ndihma nga Bundesveri Gjerman nuk ka munguar asnjëherë për FSK-në dhe ky donacion do të ndihmojë ngritjen e kapaciteteve mjekësore të FSK-së, në nivelin më të lartë. Vlera e këtij donacion kap shumën prej 140.000 Euro.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr vizitoi FSK-në, në 10 vjetorin e Pavarësisë

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zoti Rrustem Berisha ka pritur sot në takim zyrtar komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës (SHBA), gjeneral majorin Timothy Orr me bashkëpunëtorë. Gjenerali Orr ka ardhur për të marrë pjesë në 10-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës.

Ministri Berisha ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gardën Kombëtare të Ajovës dhe gjeneralin Orr, për përkrahjen dhe ndihmat materiale dhe profesionale që po japin për FSK-në. Vetëm gjatë vitit të kaluar, tha ministri kemi pasur 110 aktivitete bilaterale të përbashkëta me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Ministri Berisha duke iu drejtuar gjeneralit Orr, tha se "është kënaqësi e veçantë, për ne, që të kemi në 10- vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, sepse ky përvjetor është edhe i Juaji. Ju jeni në shtëpinë tuaj të dytë". Ministri Berisha gjithashtu e njoftoi gjeneralin Orr, me arritjet e fundit të Ministrisë dhe FSK-së, duke theksuar sidomos ushtrimet, trajnimet, shkollimin, sukseset e pjesëtarëve të FSK-së, në akademitë më prestigjioze si në SHBA, Britani të Madhe, Turqi, Gjermani, Shqipëri, Maqedoni, Kroaci etj. E njoftoi gjithashtu edhe për integrimin e komuniteteve, ngritjen e infrastrukturës, transformimin e FSK-së, bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtar, bashkëpunimin me NATO-n. Ministri Berisha e njoftoi gjeneralin Orr edhe për ushtrimin fushor "Shqiponja 6" në të cilin do të marrin pjesë edhe shumë shtete nga rajoni dhe ato të NATO-s.

Ndërsa nga ana e tij, komandanti i Gardës së Ajovës gjenerali Orr, ministrit Berisha, komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës, dhe gjithë oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së, ju uroi 10-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Ai gjithashtu e ka përgëzuar ministrin për sukseset si dhe ka premtuar vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përgjithshëm për FSK-në.

Batalioni i Xhenios filloi rregullimin e rrugës në Budisalc të Klinës

Në bazë të bashkëpunimit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) me institucionet e vendit dhe të marrëveshjes me Komunën e Klinës, IOM-in, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar, Batalioni i Xhenios i FSK-së , më 14 shkurt 2018, Batalioni i xhenios filloi punimet në rregullimin e rrugës në fshatin Budisalc të Komunës së Klinës, në gjatësi prej 400 metrave. Në këtë ngjarje morën pjesë ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Ruairi O'Conell, kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, përfaqësues të IOM-it, Ministrisë për Komunitete dhe oficerë të KFOR-it dhe të FSK-së. FSK-ja në kuadër të misionit të vet, vazhdon t'iu kushtojë rëndësi realizimit të projekteve të ndryshme humanitare të cilat janë në shërbim të komuniteteve pa dallim etnie. Qëllimi i këtij projekti është lehtësimi i qarkullimit të banorëve të fshatit për në Manastirin e Budisalcit.



Në përvjetorin e 10-të të Shpalljes së Pavarësisë

Performuan së bashku Bendi i Forcave Ajrore Amerikane dhe ai i FSK-së



Sot (14.02.20`8) në hollin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, para punonjësve të MFSK-së, me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Bendi muzikor i Forcave Ajrore të Ushtrisë Amerikane për Evropë së bashku me Orkestrën frymore të FSK-së, ekzekutuan muzikë të larmishme. Për të përcjellë shfaqjen ishin të pranishëm zëvendësministri Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneral brigade Zymer Halimi, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, dr. Shkëlzen Sylaj si dhe stafi Ministrisë dhe FSK-së. Me këtë rast, zëvendësministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama kanë falënderuar Bendin e Forcave Ajrore të SHBA-ve për Evropë, për paraqitjen e shkëlqyeshme, në vigjilje të një ngjarje të rëndësishme në Kosovë siç është shënimi i përvjetorit të 10-të të Pavarësisë së Kosovës. Bendi nga SHBA-të dhe ai i FSK-së u përcollën me duartrokitje për paraqitjen e shkëlqyeshme.

Në Qendrën e Trajnimit në Pomozotin filloi realizimi i kursit për Kërkim–Shpëtim Urban

Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së, në Kazermën "Evropianet e Rinj" në Pomozotin, më 26.02.2018, filloi trajnimi bazik në Kërkim Shpëtim Urban, për 8 pjesëtarë të Brigadës për Reagim të Shpejtë. Gjatë trajnimit kandidatët do të mësojnë teknikat e kërkimit për viktima në ndërtesa të shkatërruara apo gjysmë të shkatërruara. Ata gjithashtu do të mësojnë teknikat e prerjes dhe shpimit që të largojnë mbetjet në mënyrë që të mundësohet një qasje më e lehtë në strukturat e shkatërruara për të ndihmuar viktimat e ngujuara. Ndihma e parë mjekësore është pjesë shumë e rëndësishme e trajnimit. Kandidatët do të mësojnë të stabilizojnë viktimat përpara se t'i largojnë ato nga zonat e rrezikshme për ndihmë mjekësore dhe t'i transportojnë për në spital.Ky trajnim i nivelit bazik gjithashtu përfshinë edhe teknikat e zbritjes me litar për të fituar qasje në hapësira të mbyllura nga lart dhe si të punohet së bashku me qentë K9 të Kërkim–Shpëtimit. Gjatë trajnimit kandidatët do t'iu nënshtrohen një numri të madh të testeve teorike dhe praktike.Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit, kandidatët do të kthehen në njësitë e tyre, ku ata do të jenë pjesë e një regjistri të personelit të kualifikuar, për të punuar në një nga ekipet e kërkim-shpëtimit profesional nga Regjimenti i Mbrojtjes Civile në Pomozotin.



Pjesëtarë të FSK-së certifikohen në trajnimin „Operacionet Paqeruajtëse”



Në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) nga data 12-16.02.2018 është mbajtur trajnimi ,,Operacionet Paqeruajtëse” në të cilin kanë marrë pjesë 25 pjesëtarë nga të gjitha njësitë e FSK-së. Trajnimi u realizua nga instruktorët e KFOR-it turk, të cilët ligjëruan temat që kanë të bëjnë me operacionet paqeruajtëse. Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm: shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore koloneli Naim Haziri, shefi i Shtabit të Brigadës së Mbështetjes Operacionale nënkoloneli Sami Hajrullahu, komandanti i Kontingjentit turk në Kosovë, koloneli Sinan BARIM, koloneli Metin Sinic, këshilltar në MFSK, atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovë, nënkoloneli Rusen Abidinoglu, oficerë e nënoficerë të FSK-së dhe KFOR-it turk në Kosovë.

Shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Naim Haziri, falënderoi instruktorët nga Turqia për ndihmën dhe kontributin që kanë dhënë dhe po japin në vazhdimësi për ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së. ,,Pas krijimit të FSK-së, ne kemi pas nevojë për mbështetje, dhe njëri nga shtetet që i është përgjigjur kërkesave tona, qoftë me trajnime qoftë me pajisje ka qenë Turqia. Ne jemi në fazën e transformimit dhe kemi shumë plane për realizimin e trajnimeve gjatë këtij viti dhe nëse ndodh transformimi, besojmë fuqishëm se Turqia do të na mbështesë në avancimin e mëtejmë profesionalë”. Koloneli Haziri në fund kërkoi nga pjesëtarët e FSK-së që njohuritë e fituara nga instruktorët e Akademisë turke t’i përcjellin në njësitë ku ata shërbejnë.

Ndërsa, komandanti i Kontingjentit turk në Kosovë, koloneli Sinan BARIM, falënderoi shefin e Shtabit të KFT-së, kolonelin Naim Haziri dhe të gjithë të pranishmit në këtë ceremoni. “Ne si kryesi e KFOR-it turk në Kosovë, ndiejmë kënaqësi për mundësinë që na është dhënë për të ndihmuar FSK-në dhe Kosovën, dhe jemi të gatshëm që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen në mes dy shteteve tona”. Ceremonia përfundoi me ndarjen e mirënjohjeve dhe certifikatave për instruktorët dhe për pjesëtarët që u trajnuan.

Ushtari Alban Fazliu i dyti në Maratonën Kombëtare të Krosit në Shqipëri

Me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Sporteve Ushtarake, “CISM DAY-RUN FOR PEACE’’, në Maratonën e mbajtur në Tiranë, më 12.02.2018, morën pjesë 10 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë iu bashkuan ushtrive të 135 vendeve nga mbarë bota në Ditën Ndërkombëtare të Sporteve në Ushtri. Në maratonën e Tiranës morën pjesë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të të gjitha gradave dhe nga të gjitha komandat, njësitë dhe repartet e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Maratona u zhvillua në Kodrat e Liqenit Artificial në Tiranë. Pjesëtarët e FSK-së, gjatë këtij evenimenti ndërkombëtar kanë shfaqur një paraqitje të shkëlqyeshëm dhe disiplinë shembullore. Garat u zhvillua në dy disiplina, 10 km për vrapuesit djem dhe 6 km për vrapueset vajza.

Në nivelin individual vendin e parë e zuri atleti i Ushtrisë së Shqipërisë kapiten Bledar Mesi, vendin e dytë e zuri ushtari i FSK-së Alban Fazliu, ushtar i Brigadës të Reagimit të Shpejtë, ndërsa në renditjen ekipore FSK-ja, zuri vendin e tretë.

Certifikatat për tri vendet e para në të dyja disiplinat i dorëzoi ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku. Pasi uroi fituesit dhe përgëzoi pjesëmarrësit në garë, ministrja Xhaçka theksoi rëndësinë e meritokracisë, për të cilën tha se do të jetë themelore për karrierën në Forcat e Armatosura. Ministrja Xhaçka përgëzoi edhe ushtarët e FSK-së, të cilët treguan përgatitje të lartë fizike.

Dita e vrapimit zhvillohet çdo vit nga vendet anëtare të kësaj organizate duke u kthyer në ditën ku ushtarakë dhe civilë vrapojnë së bashku në gjithë botën nën flamurin e sportit dhe paqes. Ky aktivitet ka për qëllim promovimin e sportit masiv në Forcat e Armatosura.



FSK-ja vizitohet nga nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës



Në kuadër të shënimit të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, shumë nxënës të shkollave fillore dhe të institucioneve tjera parashkollore, më 14 shkurt 2018, kanë vizituar kazermën “Adem Jashari” të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Departamenti për Marrëdhënie Ushtarako–Civile ka organizuar pritjen e nxënësve në ambientet e kazermës ,,Adem Jashari” duke u ofruar atyre një organizim për të parë të arriturat e FSK-së dhe organizimet që janë duke u bërë për shënimin e 10-vjetorit.

Nxënësit ishin mjaft të interesuar të dinin për punën e pjesëtarëve të FSK-së. Ata përcollën nga afër punën e kadetëve dhe të Policisë së Forcës, po ashtu vizituan bibliotekën si dhe më pas për ta u shfaq një film dokumentar me aktivitetet e FSK-së. Nxënësve u bëri shumë përshtypje përgatitja e kuadrateve për manifestimin e 10-vjetorit të Pavarësisë të cilët do të parakalojnë më datë 17 Shkurt në sheshin ,,Nëna Terezë”.

Nxënësit ishin të moshave të ndryshme të ardhur nga shumë shkolla të Prishtinës me rrethinë dhe nga disa shkolla nga qytete të tjera të Kosovës. Pas vizitës ata u larguan duke iu uruar 10-vjetorin e Pavarësisë të gjithë pjesëtarëve të FSK-së .

FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 67 • 13 Prill 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

Presidenti Thaçi gradon dhe emëron gjeneralët e FSK-së

Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi në cilësinë e Komandantit Suprem të FSK-së dhe në bazë të kompetencave kushtetuese, në koordinim me ministrin dhe komandantin e FSK-së, më 6 mars 2018, në prani të ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës zotit Rrustem Berisha dhe komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka bërë gradime dhe emërime të gjeneralëve të FSK-së si në vijim: Bashkim Jashari nga gjeneral brigade gradohet gjeneralmajor; Zymer Halimi nga gjeneral brigade gradohet gjeneralmajor; gjeneral brigade Enver Cikaqin emërohet Komandant i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së; Kolonel Irfete Spahiun gradohet gjeneral brigade dhe po ashtu emërohet Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes; Naim Haziri nga kolonel gradohet gjeneral brigade dhe emërohet Komandant i Brigadës për Mbështetje Operacionale; Xhevahir Gecin nga kolonel gradohet gjeneral brigade dhe emërohet ZV. Komandant i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së; Fadil Hadergjonajn nga kolonel gradohet gjeneral brigade dhe emërohet komandant i Brigadës së Reagimit të Shpejtë; Skënder Zhitia nga kolonel gradohet gjeneral brigade dhe emërohet shef i Departamentit të Personelit në MFSK. Irfete Spahiut bëhet femra e parë në FSK e cila bartë gradën e gjeneralit.



Ministri Rrustem Berisha priti në takim drejtorin e Qendrës Marshall, Keith Dayton



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Rrustem Berisha, priti, më 20 mars 2018, në një takim zyrtar drejtorin e Qendrës Evropiane për Studime të Sigurisë "George C. Marshall", z. Keith W. Dayton.

Ministri Berisha, me këtë rast, ka falënderuar drejtorin e Qendrës Marshall, z Dayton për vizitën dhe mbështetjen që i ka dhënë kjo qendër FSK-së për një kohë të gjatë, duke i trajnuar dhe përgatitur një numër të madh të pjesëtarëve të saj në Qendrën Marshall në Garmish të Gjermanisë. Gjatë takimit, ministri Berisha dhe drejtori Dayton, biseduan për vazhdimin e bashkëpunimit në mes FSK-së dhe Qendrës Marshall. Ministri Berisha po ashtu e njoftoi z. Dayton edhe me zhvillimet e përgjithshme të FSK-së, në veçanti ai foli për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal; bashkëpunimin me NATO-n; Gardën Kombëtare të Ajovës; NALT-in, (Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për MFSK/FSK-në); memorandumet e bashkëpunimit me shtetet anëtare të NATO-s; plotësimin e kapaciteteve operacionale; integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në FSK, në veçanti të komunitetit serb; përqindjen e përfaqësimit të gjinisë femërore dhe gradimin e femrës së parë në gradën gjeneral, si dhe për zhvillimet rreth procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Nga ana e tij, drejtori i Qendrës Marshall, Keith Dayton, duke falënderuar ministrin Berisha për pritjen, shprehu edhe kënaqësinë e tij për arritjet e FSK-së. Ai njëherazi lavdëroi edhe pjesëtarët e FSK-së për sukseset e treguara gjatë shkollimit të tyre në Qendrën Marshall. Gjithashtu, drejtori i Qendrës Marshall u zotua dhe premtoi se mbështetja për mekanizmat e sigurisë do të vazhdojë, dhe se bashkëpunimi me FSK-në do të thellohet edhe më tepër.

Ministri Berisha dhe ambasadori O'Connell nënshkruan amendamentin për vazhdimin e marrëveshjes së bashkëpunimit

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha dhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut, zotëri Ruairi O'Connel nënshkruan më 28 mars 2018, në ambientet e MFSK-së, amendamentin e Marrëveshjes Bilaterale të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për FSK-në dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, të nënshkruar në vitin 2009.

Fillimisht, në takimin e përbashkët të ministrit Berisha dhe ambasadorit O'Connel u bisedua për marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet dy shteteve me theks të veçantë për marrëdhëniet e shkëlqyera në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe për gatishmërinë e të dyja palëve që këto marrëdhënie të ngritën në nivel edhe më të lartë në të ardhmen.



Me këtë rast, ministri Berisha shprehu mirënjohjen për angazhimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut dhe qeverisë së saj si partner strategjik i Republikës së Kosovës; për përkrahje gjatë gjithë procesit historik të lirisë, pavarësisë dhe tani në synimin e Republikës së Kosovës në rrugën drejt integrimit euroatlantik. Ministri Berisha sidomos e theksoi rolin kyç të Mbretërisë së Bashkuar në mbështetje të FSK-së për shkollime, trajnime dhe ushtrime fushore. Ministri me theks të veçantë përmendi kontributin në rrafshin diplomatik e këshillues përmes ushtarakëve dhe personelit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe FSK-në, duke përfshirë edhe këshilltarin bilateral në ministri e gjithashtu edhe atasheun e mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut në Republikën e Kosovës.

Nga ana e tij, ambasadori O'Connel e përgëzoi ministrin Berisha për angazhimin dhe sukseset konkrete të FSK-së, sidomos për suksesin e treguar në integrimin e komuniteteve jo shumicë në FSK. Në fund, ministri Berisha dhe ambasadori O'Connel nënshkruan amendamentin e Memorandumit të Bashkëpunimit për vazhdimin e bashkëpunimit bilateral edhe në të ardhmen.

Ministri Rrustem Berisha priti diplomatin e Sllovakisë Ljubomir Batary



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha, më 26 mars 2018, priti për herë të parë në takim shefin e Zyrës Ndërlidhëse të Republikës së Sllovakisë në Republikën e Kosovës, zotëri Ljubomir Batary. Në takimin e përbashkët të ministrit Berisha dhe shefit të Zyrës sllovake u bisedua për aktualitetin politik dhe të sigurisë në rajon dhe më gjerë, si dhe për angazhimin e dy institucioneve të të dyja vendeve për gjetjen e mundësive dhe fushave të bashkëpunimit me interes.

Me këtë rast, ministri Berisha e falënderoi diplomatin sllovak për kontributin që ka dhënë Republika e Sllovakisë në kuadër të KFOR-it për FSK-në. Po ashtu e njoftoi atë mbi zhvillimin e FSK-së, profesionalizimin, integrimin e komuniteteve dhe grave, si dhe për sukseset e vazhdueshme të pjesëtarëve të FSK-së kudo në shkollime, trajnime dhe operacione të ndryshme jashtë vendit. Gjithashtu, ministri Berisha e njoftoi Z. Batary edhe me gatishmërinë e FSK-së për të kontribuar, me kapacitete të veçanta specialistike, në të mirë të paqes së përgjithshme kudo ku ka nevojë. Më pas, ministri Berisha në pika të shkurtra shpalosi ecurinë e aktiviteteve rreth transformimit të FSK-së, duke ripërsëritur faktin se transformimi do të jetë transparent, i koordinuar dhe do të bëhet me konsensus të plotë të faktorit të brendshëm politik.

Nga ana e tij, shefi i Zyrës Ndërlidhëse të Republikës së Sllovakisë, z. Ljubomir Batary e konfirmoi gatishmërinë e shtetit sllovak për mbështetjen e Kosovës në shumë fusha, duke qenë se Sllovakia e konsideron Kosovën si vend mik: ,, Qëllimi ynë është fleksibil dhe pragmatik, që të ndihmojmë Kosovën që të mos mbetet prapa",-tha ai. Në fund, z. Batary shprehu gatishmërinë për identifikimin e fushave të bashkëpunimit në të ardhmen ndërmjet Kosovës dhe Sllovakisë.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama vizitë zyrtare në Gardën Kombëtare të Ajovës-SHBA



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Timothy Orr, nga data 21 deri më datë 25 mars 2018, qëndroi për vizitë zyrtare në shtetin Ajova të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në kuadër të kësaj vizite, gjeneral Rama ka zhvilluar takime përmbajtjesore me gjeneralin Orr dhe stafin e tij. Në këto takime është biseduar lidhur me thellimin dhe avancimin e Programit të Partneritetit Shtetëror në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Gjeneral Rama në këtë vizitë pati mundësi të njoftohet për së afërmi me metodologjinë e përgatitjes, trajnimit dhe gatishmërisë së pjesëtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës për zhvillim në bazë të planit vjetor.

Për të treguar rëndësinë e veçantë që ka ky program, gjeneral Rama, para pjesëtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës, paraqiti një prezantim lidhur me aktivitetet e përbashkëta dhe të arriturat e FSK-së, që nga viti 2011, kur është nënshkruar marrëveshja e Programit të partneritetit shtetëror.

Gjeneral Rama ka falënderuar gjeneralin Orr për kontributin dhe përkrahjen e jashtëzakonshme të Gardës Kombëtare të Ajovës, në zhvillimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. FSK-ja dhe Garda Kombëtare e Ajovës, në kuadër të marrëveshjes së Partneritetit shtetëror Kosovë-Ajovë, që nga viti 2011, realizojnë për çdo vit aktivitete të përbashkëta. Garda Kombëtare e Ajovës prinë sa i përket bashkëpunimet që FSK-ja ka me shtetet tjera mike.

Në kazermën "Adem Jashari" zhvillohet ceremonia e ndërrimit të komandës

Komandant i Forcave Tokësore emërohet gjeneral brigade Enver Cikaqi



Në kazermën ,,Adem Jashari'' të FSK-së në Prishtinë, më 15 mars 2018, u zhvillua ceremonia e ndërrimit të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së. Ceremonia filloi me parakalimin e flamurtarëve dhe intonimin e himnit shtetëror të Republikës së Kosovës. Në ceremoni morën pjesë: zv. ministri i MFSK-së Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, drejtori i NLAT-it, gjenerali Hofmann, gjeneral majori Zymer Halimi, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Irfete Spahiu, gjeneral brigade Naim Haziri, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, përfaqësues të korit diplomatik, përfaqësues të NALT-it dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Pas leximit të dekret-ligjit të presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për emërimin e gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandant i Komandës së Forcave Tokësore dhe zëvendës komandant të Forcës së Sigurisë së Kosovës, filloi ceremonia e ndërrimit të Komandës së Forcave Tokësore.

Në fjalën e tij, zv. ministri Ramadani tha se: "FSK-ja është institucioni më i besueshëm në Kosovë, dhe kjo është një arritje e madhe falë angazhimit dhe përkushtimit tuaj. Një institucion profesional sikurse është FSK-ja, është fytyra e Kosovës së re, është shembulli se si të rinjtë e të rejat e duan vendin e vet dhe duan t'i shërbejnë Kosovës. Nëse ëndrra e gjeneratave të tëra ka qenë Liria dhe shteti i Kosovës, ëndrra që po e jetojmë sot është që flamuri i Kosovës të jetë bashkë me të NATO-s, në kontributin për sigurinë kudo nëpër botë" tha në fund zv. ministri Ramadani.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha: "Për mua si komandant i FSK-së, është nder dhe privilegj që këtu së bashku me të gjithë ju të shënojmë këtë ditë të veçantë të ndërrimit të komandës ndërmjet dy gjeneralëve, gjeneral majorit Gëzim Hazrollit dhe gjeneral brigade Enver Cikaqit. FSK-ja gjatë viteve që lamë pas ka ndërtuar dhe zhvilluar kapacitetet e veta duke bërë tranzacionin nga konsumues në prodhues të sigurisë. Ne vazhdojmë të ofrojmë gatishmërinë tonë që me këto kapacitete të kontribuojmë në ngritjen e stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë. Edhe këtë vit FSK-ja është vlerësuar si institucioni më i besueshëm në vend. Këtë besim të qytetarëve e kemi arritur falë angazhimit dhe përkushtimit profesional duke qenë gjithmonë afër me qytetarët dhe duke iu afruar atyre një ambient të sigurt. Kemi arritur shumë suksese, mirëpo kemi ende punë për të bërë" tha në fund gjeneral Rama.

Në fund u bë dorëzim-pranimi i detyrës së komandantit të KFT-së, nga gjeneral majori Gëzim Hazrolli tek gjeneral brigade Enver Cikaqi.

FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Në kazermën „Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë u mbajt ceremonia e 20-të vjetorit të "Epopesë së UÇK-së"

Në Kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës, dhe nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinajt, më 5 mars 2018, u mbajt manifestimi qendror në shënimin e 20-të vjetorit të Epopesë së UÇK-së, në nderim të Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit të rënë për liri. Të pranishëm në manifestim ishin presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, Rifat Jashari, ministra, deputet, veteranë, invalidë, familjarë të dëshmorëve, qytetarë dhe nxënës të shkollave të Kosovës. Pas revistës së kuadrateve të FSK-së, nga presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, manifestimi filloi me intonimin e himnit shtetëror dhe kombëtar. Pastaj, presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramarush Haradinaj, ministri i MFSK-së Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari vendosen kurora lulesh pranë Obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit.

Në manifestimin e njëzetë vjetorit të Epopesë së UÇK-së,



presidenti Hashim Thaçi, në fjalën e tij pos tjerash tha: "Para dy dekadave Kosova sublimoi tërë historinë e përpjekjeve shekullore për liri dhe pavarësi, duke iu kundërvënë aparatit administrativ, policor dhe ushtarak të Beogradit. Kjo kundërvënie u bë përmes rezistencës së armatosur, luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila doli nga gjiri i qytetarëve tanë. Qëndresa e komandantit Adem Jashari dhe bashkëluftëtarëve të tij u shndërrua në masivizim dhe zgjerim të jashtëzakonshëm të radhëve të UÇK-së". Presidenti Thaçi, para pjesëtarëve të FSK-së, shtoi se: "Ju jeni në themelet e identitetit tonë si shtet i pavarur, që prej kohës së transformimit deri në strukturimin e sotëm. Duke marrë parasysh përgatitjen tuaj, bashkëpunimin e suksesshëm dhe përkrahjen që keni nga KFOR-i dhe NATO-ja, ju faktikisht po dëshmoni pjekurinë dhe aftësinë për të ushtruar misionin tuaj themelor, atë të Forcave të Armatosura të Kosovës", u shpreh presidenti Thaçi.

Ndërsa, kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj tha se "Sot, kur para nesh parakalon Forca e Kosovës, në fytyrat e tyre shëmbëllejnë ushtarët e lirisë. Ju, që po krijoni një imazh të ri të Kosovës me shumë mund e shumë sakrifica me mbështetjen e aleatëve tanë strategjik, së shpejti do të merrni edhe besimin kushtetues si Ushtri e Kosovës dhe si anëtare e NATO-s. Më tej kryeministri shtoi:" Pra, ushtarë e oficerë, të gjithë ju prezentë, sot ne mund të kthehemi të nderojmë dhe kujtojmë me respekt të rënët për liri, të kujtojmë me respekt Epopenë e UÇK-së dhe rënien heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe të betohemi në drejtimin tonë për një liri të përjetshme", tha në fund të fjalës së tij, kryeministri Haradinaj.

Kurse vëllai i komandantit legjendar Adem Jasharit, Rifat Jashari, në emër të familjes Jashari kërkoi bashkimin e shqiptarëve për ta quar vendin përpara. Ai tha se sot po kujtojmë të gjithë të rënët në Kosovë. "Sot jemi tubuar në 20 vjetorin të Epopesë së UÇK-së të përkujtojmë bijtë dhe bijat mbarë kombit shqiptar që ditë ti kapin armët dhe ti kundërvihen forcave serbosllave, që dikur ata kanë zotëruar këtë vend ku jemi ne sot. Ne pasardhësit e tyre e kemi obligim moral dhe të domosdoshëm për hirë të bijave dhe bijve, për hirë të gjakut dhe të luftës, të ulemi dhe të gjejmë gjuhën e përbashkët dhe të qojmë Kosovën përpara, ashtu siç na ka hije, si popull dhe si komb".



Në nderim të "Epopesë së UÇK-së" ministri dhe komandanti i FSK-së bënë homazhe te varri i Komandantit Legjendar Adem Jashari



Me rastin e manifestimit jubilar të 20 vjetorit të "Epopesë së UÇK-së", rezistencës heroike të familjes Jasharaj, të luftëtarëve tjerë, si dhe rënies së komandantit legjendar Adem Jashari, pjesëtarëve të familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve për liri, më 6 mars, ministri i FSK-së Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, të shoqëruar nga gjeneralë, oficerë madhorë të FSK-së, zyrtarë të lartë të ministrisë, bënë homazhe te varri i Komandantit Legjendar Adem Jashari në kompleksin memorial në Prekaz.

Pas homazheve delegacioni i lartë i MFSK-së dhe FSK-së bënë vizitë në familjen Jashari, ku u pritën nga kryefamiljari Rifat Jashari. Me këtë rast ministri Berisha para mediave deklaroi: "Ishim sot në vizitë në familjen Jasharaj, për të qenë pjesë e kësaj ceremonie, pjesë e përballimit të këtyre kujtimeve të ditëve të vështira, që i kanë pasur. Siç e dimë kanë qenë ditë të vështira për familjen Jasharaj dhe për të gjithë popullin shqiptarë. Kemi pasur dëshirë të jemi pjesë e kësaj ceremonie, kjo është një frymëzim për të gjithë neve, që të vazhdojmë me punën tonë drejt forcimit të shtetit tonë, institucioneve shtetërore dhe të institucioneve të sigurisë. Unë mendojë se çdo herë e më shumë do të vijmë me vlera raportuese, në çdo përvjetor dhe të njihen me to të gjithë qytetarët".

FSK-ja në takimin e drejtorëve "Karta e Adriatikut –A5"

Dje (12.03.2018) u zhvillua takimi i radhës i drejtorëve të drejtorive të Politikave dhe Planeve të Ministrive të Mbrojtjes-Karta e Adriatikut A-5. Z. Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Planeve të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, mori pjesë në këtë takim. Takimi u zhvillua në Podgoricë nën organizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Malit të Zi. Takimi kishte në fokus stabilitetin rajonal, ndërkaq u zhvilluan diskutime lidhur me planin e veprimeve për këtë vit.

Drejtori Faruk Geci, e vlerësoi si shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Drejtorisë së Politikave dhe Planeve të Ministrisë për FSK-në, veç tjerash edhe për faktin se u shpalos kërkesa e të gjitha shteteve pjesëmarrëse të Kartës së Adriatikut, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, për anëtarësimin e Kosovës në Kartën e Adriatikut A-5. Ai tha se është synim i yni që gjatë kryesimit të Malit të Zi, të gjendet konsensusi i përbashkët për anëtarësimin e Kosovës në A-5.

Në këtë takim u nënshkrua edhe Plani dypalësh i bashkëpunimit në mes të dy drejtorive të politikave dhe planeve të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Malit të Zi, nga Faruk Geci dhe Ivica Ivanoviç. Ky është plani i parë i bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe MM të Malit të Zi, përkatësisht këtyre dy drejtorive, dhe i cili plan parasheh realizimin e 9 aktiviteteve të bashkëpunimit në mes të këtyre dy drejtorive, të cilat do të realizohen në Kosovë dhe Mal të Zi.

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandës

Komandant i ri emërohet gjeneral brigade Irfete Spahiu

Në kazermën ,,Skënderbeu'' të FSK-së në Ferizaj, më 13 mars 2018, u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandës së Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Komandanti i deritanishëm, gjeneral brigade Enver Cikaqi ia dorëzoi detyrën komandantit të sapoemëruar gjeneral brigade Irfete Spahiu.

Gjeneral brigade Irfete Spahiu është oficerja e parë grua, e graduar në këtë rang, nga radhët e FSK-së, si dhe oficerja e parë në detyrën e Komandantit të Brigadës.



Në ceremoninë solemne ishin të pranishëm ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha, zv. ministri Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, drejtori i NLAT-it, gjenerali Hofmann, ambasadorja e Turqisë, zonja Kiliq, komandanti i Kampit Bonstell, gjeneralët e FSK-së, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, përfaqësues të korit diplomatik të akreditуar në Kosovë, përfaqësues të KFOR-it, NALT-it, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Ceremonia filloi me intonimin e himnit shtetëror. Më pas u lexua dekret-ligji i presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për gradimet dhe emërimin e gjeneral brigade Irfete Spahiu komandant i KDS-së. Me këtë rast, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha tha: "Jam shumë i nderuar që në dorëzim-pranimin e detyrave pas dekretimit të presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, e fillojmë pikërisht me Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes. Jo rastësisht është marrë vendimi që ndërrimi të bëhet nga KDS-ja, për vetë faktin se është një rast i veçantë për të gjithë ne, sepse me dekretin e presidentit është dekretuar dhe është graduar një gjeneral femër e cila do të emërohet në detyrën e komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, prandaj është rast i veçantë, është rast historik për FSK-në, për gradimin e gjeneral Irfete Spahiut. Arsye e dytë pse kemi filluar këtu është vetë misioni i KDS-së, sepse kjo është gur themel i suksesit jo vetëm i kësaj njësie, por edhe i të gjitha njësive të FSK-së dhe Ministrisë së FSK-së. Ministri Berisha përgëzoi gjeneral Cikaqin për të gjitha të arriturat në krye të këtij institucioni, duke shtuar se "këto suksese na kanë bërë që të ndihemi krenarë dhe të mburremi me të arriturat e KDS-së".

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në ceremoni tha: "Kjo është një ditë e veçantë për mua si komandant i FSK-së. Gjeneral Cikaqi gjatë shërbimit në FSK ka treguar një performancë të jashtëzakonshme si në aspektin profesional edhe në gatishmërinë e tij për ngritjen e kësaj njësie që nga themelimi i FSK-së. Si rezultat i kësaj njësie dhe punës tuaj me trajnime të shumta bazike apo specialistike, jemi sot këtu. Prioritet imi është qëndrueshmëria e institucionit dhe zhvillimi i mëtejmë i tij, duke bashkëpunuar ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, në mënyrë që trajnimet tona të jenë profesionale dhe të bazuara në standardet e NATO-s, sepse ky është qëllimi dhe synimi ynë, që ne të jemi pjesë në të ardhmen e strukturave Veri-Atlantike dhe pjesë e NATO-s".

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, duke iu drejtuar gjeneral Spahiut, tha: shpresoj dhe besoj se gjeneral Spahiu, do ta avancoje edhe më tutje këtë njësi për një zhvillim profesional për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, duke marrë për bazë edhe sfidat dhe obligimet e reja shtesë".

Në fund, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe gjeneral brigade Irfete Spahiu bënë dorëzim-pranimin e Komandës.

U zhvillua konferenca finale planifikuese e ushtrimit fushor „Shqiponja 6"

Në përmbylljen e konferencës finale planifikuese të ushtrimit fushor ,,Shqiponja 6 ", e cila është realizuar nga data 12-16.03.2018, drejtori i ushtrimit gjeneral brigade Naim Haziri, më 16 mars 2018, bëri një prezantim të aktiviteteve gjatë konferencës finale planifikuese të ushtrimit fushor ,,Shqiponja 6".

Ai, me këtë rast, theksoi se gjatë kësaj konference është bërë finalizimi i listës së ngjarjeve dhe incidenteve kryesore me qëllim të testimit të kapaciteteve bazuar në objektivat e trajnimit të ushtrimit fushor, gjithashtu është punuar edhe në mbështetjen reale të ushtrimit, si dhe një ditë së bashku me partnerët është bërë rikonicioni i terrenit ku do të realizohet ushtrimi. I pranishëm në konferencë ishte edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zv. komandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Janos Scombok, drejtori i Drejtorisë së Operacioneve gjeneral majori Gëzim Hazrolli, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, shefi i këshilltarëve të NALT-it, kolonel Nixon, shefi i G3 të KFT-së, kolonel Bashkim Shillova, oficerë dhe nënoficerë pjesëmarrës në planifikimin e ushtrimit fushor ,,Shqiponja 6" partnerët rajonalë dhe strategjikë të Kosovës, si: Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Sllovenia, Gjermania, Anglia, Turqia, Iowa, Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR), KFOR-i, NALT-i, si dhe agjencitë vendore: Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Policia e Kosovës, Qendra e Situatave në nivel qendror, etj.




Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë konferencës përgëzoi të gjithë akterët për punën dhe aktivitetin e përgjithshëm, duke pas parasysh që ky ushtrim është më kompleksi dhe duhet angazhim maksimal në realizimin e tij, deri në ekzekutim. "Unë dëgjova me kujdes gjithë planifikimin dhe shqetësimet tuaja, që keni paraqitur gjatë planifikimit. Ne jemi këtu, që t'i zgjidhim këto shqetësime në afatin sa më të shpejtë. Shumë e rëndësishme është ndërveprueshmëria me faktorin vendor, si në nivel lokal dhe atë qendror, e gjithsesi partnerët që po mbështesin ushtrimin me personel dhe pajisje". Në fund, gjeneral Rama, premtoi mbështetjen e tij, në realizimin me sukses të ushtrimit fushor "Shqiponja 6" në çdo aspekt.

Ndërsa, zëvendës komandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Janos Csombok u nda i kënaqur me planifikimin e bërë. Ai theksoi se, "se ky ushtrim ka rëndësi të veçantë për shkak se ofron bashkëpunimin regjional dhe mundësinë e bashkëveprimit.

Ushtrimi fushor "Shqiponja 6" do të zhvillohet nga fundi i muajit prill e deri në javën e dytë të muajit maj.

Diplomojnë rekrutët e rinj të FSK-së nga radhët e komuniteteve jo shumicë





Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj, më 16 mars 2018, u mbajt ceremonia e diplomimit të rekrutëve të rinj të FSK-së, nga radhët e komuniteteve jo shumicë, gjenerata e parë për vitin 2018. Në ceremoni ishin prezent: kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Ruari O'Conelli, e ngarkuara me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Colleen Hyland, drejtori i NALT-it, gjenerali Ralf Hofmann, zëvendës komandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Janos Csombok, atashe ushtarakë si dhe oficerë, nënoficerë dhe familjarë të rekrutëve.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i uroi rekrutët e rinj të FSK-së, nga radhët e komunitetit jo shumicë për përfundimin me sukses të trajnimit bazik duke iu dëshiruar fillim të mbarë, shërbim dhe karrierë të suksesshme në FSK, në shërbim të vendit. Ai, gjithashtu, i përgëzoi edhe familjet e rekrutëve të rinj: „ Ju uroj juve dhe familjet tuaja për zgjedhjen që keni bërë, duke u përcaktuar që t'i shërbeni vendit në të mirë të zhvillimit, paqes dhe prosperitetit të qytetarëve. Qeveria jonë është e vendosur për zhvillimin e përbashkët, integrimin e të gjithëve për të kontribuar bashkërisht për ndërtimin e paqes dhe sigurisë në vend, rajon dhe me gjerë''.

Ndërsa, ministri Rrustem Berisha, duke iu drejtuar të pranishmëve tha: "Kam nderin dhe privilegjin që në këtë ceremoni, si ministër i FSK-së, t'ju uroj diplomimin e rekrutëve nga komuniteti jo shumicë. Ceremonia e sotme na gëzon shumë, sepse dëshmon se FSK-ja është bërë forcë e besueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, forcë shumetnike, e hapur për të gjithë dhe në shërbim të të gjithëve". Duke iu drejtuar rekrutëve të sapo diplomuar, ministri Berisha tha:" Ky angazhim dëshmon se ju si qytetarë të shtetit të Kosovës keni bërë zgjidhjen e duhur, kur jeni përcaktuar për të shërbyer në FSK, si strukturë e të gjithë qytetarëve, pa dallime etnike, race apo gjinie. Njëri nga prioritetet tona është edhe integrimi i komuniteteve jo shumicë në strukturën e FSK-së. Bazuar në Strategjinë për integrim të komuniteteve dhe në këtë angazhim, aktualisht FSK-ja e ka tejkaluar kuotën prej 10% të përfshirjes së komunitetit jo shumicë. FSK-ja për disa vite me radhë është vlerësuar nga qytetarët si institucioni më i besueshëm i vendit, prandaj është detyrë e juaja dhe jona për ta bërë FSK-në, edhe në të ardhmen, forcë kompakte, shumetnike dhe të besueshme".

Ndërsa e ngarkuara me punë në Ambasadën e SHBA-ve, Colleen Hylland, uroi rekrutët e rinj për përfundimin me sukses të trajnimit bazik si dhe i përgëzoi ata për kurajën e treguar ndërsa familjarët e rekrutëve për mbështetje dhe inkurajim. Zonja Hylland konfirmoi edhe një herë mbështetjen për FSK-në: „E keni respektin dhe admirimin tim dhe të kolegëve të mi. FSK-ja do të vazhdojë të ketë mbështetjen e fortë të Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë".

Në fund, u zhvillua ceremonia e ndarjes së certifikatave dhe betimit për shërbim në FSK. FSK-së, iu bashkuan edhe 34 rekrutë nga radhët e komuniteteve jo-shumicë, dhe me këtë numri i pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve ka arritur në 276 pjesëtarë ose 11.10%.

Ndërsa, nga komuniteti serb deri më tani janë rekrutuar 130 pjesëtarë ose 5.28%, nga i gjithë territori i Kosovës.

Mbahet ceremonia e ndërrimit të komandës në Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Istog

Në kazermën „Ushtarët e NATO-s" të Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së në Istog, më 19 mars 2018, u mbajt ceremonia e ndërrimit të komandës së BRSH-së, nga gjeneral brigade Xhevahir Geci te gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj. Në ceremoninë solemne të pranishëm ishin: ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralë të FSK-së, përfaqësues të institucioneve lokale, Policisë së Kosovës, përfaqësues të KFOR-it, NALT-it, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Ceremonia filloi me intonimin e himnit shtetëror. Pas leximit të dekret-ligjit të presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për gradimet dhe emërimin e gjeneral brigade Xhevahir Gecit, zv. komandant i Komandës së Forcave Tokësore dhe gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj komandant i BRSH-së, filloi ceremonia e ndërrimit të komandës së BRSH-së.

Ministri Rrustem Berisha falënderoi gjeneralin Xhevahir Geci për punën e bërë në ngritjen dhe avancimin e BRSH-së, ndërsa komandantit të ri, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj i ka uruar detyrën duke shprehur bindjen se gjeneral Hadërgjonaj, do ta avancojë zhvillimin dhe operacionalitetin e BRSH-së. Ministri Berisha, gjithashtu kërkoi angazhim më të madh në ngritjen profesionale dhe ndryshim të misionit të FSK-së.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, tha se "është nder dhe privilegj, që këtu së bashku, me të gjithë ju, të shënojmë këtë ditë të veçantë të ndërrimit të komandës ndërmjet dy gjeneralëve, gjeneral brigade Xhevahir Gecit dhe gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj.". Ai veç tjerash tha: "Pjesëtarët e BRSH-së, kanë marrë pjesë në shumë gara; si ato vendore ashtu edhe ndërkombëtare, ku kanë demonstruar shkathtësi të jashtëzakonshme individuale dhe kolektive duke fituar çmime të ndryshme. Të gjitha këto arritje dëshmojnë edhe njëherë se FSK-ja është forcë profesionale, e aftë, e disiplinuar dhe e gatshme për të kontribuar në sigurinë rajonale dhe globale. Komandanti i FSK-së, foli edhe për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së dhe bashkëpunimin me partnerë. Bashkëpunimi i ngushtë me partnerët ndërkombëtarë është garanci se ne jemi në rrugë të drejtë të trajnimit sipas standardeve të NATO-s, por edhe të jemi të ndërveprueshëm në zhvillimin e operacioneve të përbashkëta". Kurse, komandanti i deritashëm i BRSH-së, gjenerali Xhevahir Geci, pos tjerash tha: "Sukseset e BRSH-së, kaluan shumë herë kufijtë e vendit tonë. Flamuri i Kosovës, beretat e zeza dhe simboli me ujk, u bënë të njohura anë e mbanë globit si rezultat i sukseseve të njësive dhe pjesëtarëve tanë gjatë shkollimeve, ashtu edhe në garat dhe ushtrimet ndërkombëtare".



Në fund u bë dorëzim-pranimi i detyrës së komandantit të BRSH-së nga gjenerali Xhevahir Geci tek gjenerali Fadil Hadërgjonaj. .

Pjesëtarët e FSK-së më të mirët në garën ndërkombëtare të mjekësisë

Në Grafenworth të Gjermanisë, më 23 mars 2018, është mbajtur gara ndërkombëtare e ashtuquajtur "Ekspert i Mjekësisë Fushore", në të cilën morën pjesë mbi 200 pjesëtarë nga shumë vende të botës, si nga: SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Danimarka, Norvegjia, Kosova etj. Pjesë e kësaj gare ishin edhe tre (3) pjesëtarë-paramedikë të Qendrës Trajnuese të Kërkim-Shpëtimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së. Gara "Ekspert i Mjekësisë Fushore" kishte për qëllim koordinimin dhe aftësimin e pjesëmarrësve në përdorimin e teknikave të reja mjekësore si dhe ngritjen e nivelit reagues gjatë fushëbetejave reale dhe fitimin e begjit.

Nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse të kësaj gare, Begjin si ekspert të mjekësisë fushore, e kanë fituar 23 pjesëmarrës. Në mesin e fituesve janë edhe dy pjesëtarë të Qendrës Trajnuese të Kërkim-Shpëtimit të RMC-së, Besart Ejupi dhe Kushtrim Hyseni, të cilët janë shpallur ndër më të mirët edhe në nivel Evrope. Vlen të theksohet se vetëm tre fitues të garës kanë arritur të marrin begjin në tentimin e parë; dy pjesëtarët e FSK-së dhe një amerikan, kurse 19 fituesit e tjerët këtë begj kanë arritur ta fitojnë pas dy e më shumë tentimeve.



Pjesëmarrësit kanë garuar në disiplinat: Aftësi luftarake, aftësi medicinale, komunikim, evakuim të viktimave, test i përgjithshëm me shkrim, navigim ditën e natën, si dhe marshim me të gjitha pajisjet në një gjatësi prej 20 kilometrave. Pjesëtarët e FSK-së, u treguan më të mirët në mesin 200 pjesëmarrësve, gjë për të cilën, nga organizatori u shpërblyen me mirënjohje. Mund të themi se suksesi i pjesëtarëve të FSK-së, në një konkurrencë kaq të madhe, është padyshim dëshmia më e mirë se FSK-ja po ecën me hapa të sigurt drejt profesionalizimit sipas standardeve të NATO-s.

Një delegacioni i Departamentit të Personelit të MFSK-së vizituan Gardën Kombëtare të Ajovës

Një delegacion i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (MBNJ) në MFSK/FSK, i kryesuar nga gjeneral brigade Skender Zhitia së bashku me kapiten Fatlum Demiri, kapiten Vjosë Maloku-Ramadani dhe rreshter major Arsim Baxhaku, nga data 1-8 mars 2018, kanë qëndruar në Gardën Kombëtare të Ajovës-SHBA. Ata ishin në një vizitë pune tetë-ditore me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave me Departamentin e MBNJ-së të kësaj force.

Gjatë kësaj vizite, pjesëtarët e MFSK/FSK-së patën mundësi që për së afërmi të njihen me: mënyrën e funksionimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në Gardën Kombëtare të Ajovës; menaxhimin e Bordeve të Karrierës për Oficerë dhe Nënoficerë (procedurat dhe mënyrat e mbajtjes së Bordeve të Gradimit dhe Mbajtjes); përparësitë dhe beneficionet e ndryshme gjatë dhe pas pensionimit; përgatitjen dhe procedimin e pjesëtarëve për t'u dislokuar jashtë vendit; operacionet e përbashkëta të burimeve njerëzore; Programin e Mentorshipit për Kadetët/Oficerët e GKA-së; mënyrat e trajnimit dhe stërvitjeve përgatitore për MOSQ-t (kategoritë e ndryshme të pjesëtarëve); Shërbimet e Qendrës për Moral, Mirëqenie dhe Rekreacion të Ushtarakëve; si dhe Qendrës për Punësim të Ajovës pas pensionimit të pjesëtarëve të GKA-së. Vlen të theksohet se gjatë kësaj vizite, delegacioni i kryesuar nga gjeneral brigade Zhitia u pritën në takime të ndryshme nga gjeneralmajor Timothy Orr, Komandant i GKA-së, gjeneral brigade Damian Donahoe, zëvendëskomandant i Manovrës së GKA-së, gjeneral brigade Steven Warnstadt, udhëheqës i Grupit Planifikues së GKA-së, si dhe gjeneral brigade (i pensionuar) Xhavit Gashi, konsull i Republikës së Kosovës në Ajova.



Delegacioni i MBNJ-ve të MFSK / FSK-së gjatë tërë kohës ishin të shoqëruar nga drejtori i G1 të Shtabit të Përgjithshëm të GKA-së, kolonel Timothy Glyn dhe ekipi i tij, si dhe nënkolonel Michael Wunn, drejtor i Programit Shtetëror të Partneritetit në mes të Ajovës dhe Kosovës.

Kadetët e Qendrës për Studime Universitare realizuan ushtrimin fushor „Pëllumbi 01-2018"

Sipas plan-programit të Qendrës për Studime Universitare (QSU), të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për vitin akademik 2017/18 është realizuar ushtrimi fushor ,,Pëllumbi 01-2018", në fshatin Zhegovc të Gjilanit, nga data 09-12 mars 2018. Aktivitetet gjatë ushtrimit fushor ,,Pëllumbi 01-2018" për kadetët e vitit IV-të kanë qenë navigimi tokësor- vlerësues, natën dhe ditën. Gjithashtu, nën mbikëqyrjen e instruktorëve të QSU-së ata kanë praktikuar organizimin dhe mbikëqyrjen e navigimit tokësor gjatë ditës dhe natës për kadetët e vitit të I-rë, II-të dhe ata të vitit të III-të.



Po ashtu sipas plan-programit kadetët e vitit të IV-të nga data 12 deri më 16.03.2018 janë duke e realizuar praktikën nëpër njësitë e Brigadës për Reagim të Shpejtë(BRSH).

Ndërkaq, aktivitetet për vitin e III-të kanë qenë të përqendruara në operacionevet urbane, ofanzive dhe defanzive në nivel togu.

Gjatë fazës së parë të trajnimit, kadetët kanë ndjekur ligjërata dhe kanë praktikuar aktivitete të ndryshme për të përforcuar njohuritë dhe shkathtësitë taktike dhe operacionale të zonave urbane. Gjithashtu, këta kadetë janë vlerësuar në navigim tokësor gjatë ditës dhe natës.

Në vazhdën e trajnimeve për operacione urbane, kadetët e vitit të III-të kanë pranuar urdhër operacional të cilin më pas e kanë zbërthyer dhe ekzekutuar në formë misioni-sulm në objektiv. Normalisht, ky mision është vëzhguar dhe vlerësuar në të gjitha fazat nga instruktorët e QSU-së.

Kadetët e vitit të I-rë dhe II-të kanë praktikuar formacionet dhe teknikat bazë në zona urbane dhe kanë qenë ekzekutues të planeve të draftuara nga viti i III-të, përderisa kadetët e vitit II-të dhe vitit I-rë janë vlerësuar në navigim tokësor ditën dhe natën.

Gjeneral Naim Haziri komandant i Brigadës për Mbështetje Operacionale

Në kazermën ,,Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë, më 30 mars u mbajt ceremonia e ndërrimit të komandës së Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO). Gjeneral brigade Naim Haziri i emëruar komandant i BMO-së, pranoi detyrën nga ushtruesi i deritashëm i kësaj detyre kolonel Avdi Rraci. Në hapje të ceremonisë u lexua dekreti i Presidentit të Republikës së Kosovës, për gradimet dhe emërimin e gjeneral brigade Naim Hazirit, komandant i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO)-së.



Zëvendësministri i FSK-së, Burim Ramadani, pasi përshëndeti të pranishmit, falënderoi gjeneral brigade Naim Hazirin dhe theksoi se detyrën e komandantit të BMO-së e merr një njeri i përkushtuar në punë dhe i cili në aktivitete të hershme ka kontribuar për lirinë dhe paqen në vend. Gjithashtu tha zëvendësministri se e vlerësoi angazhimin profesional dhe të përkushtuar në kryerje të detyrës në shërbim të atdheut. "FSK-ja është institucioni më i besueshëm në Kosovë, i vlerësuar lartë si brenda dhe jashtë vendit, dhe kjo paraqet një arritje të madhe që vjen si rezultat i angazhimit dhe përkushtimit tuaj",- tha zëvendësministri Ramadani. Të pranishmëve iu drejtua edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Ai tha se "kjo ceremoni sot është proces i natyrshëm. FSK-ja është e aftë të kryej detyrat e saj në mënyrë profesionale. Për mua si komandant i FSK-së, është nderë që sot bëjmë ndërrimin e Komandës së BMO-së gjithashtu e falënderoj për suksesin e treguar si zëvendëskomandant të BMO-së, kolonel Avdi Racin, ndërsa gjeneral brigade Naim Hazirit i urojmë suksese në detyrën e re dhe besoj në aftësitë e tij të treguara në menaxhimin e punës". Në ceremoninë solemne ishin të pranishëm zv. ministrat e FSK-së, Burim Ramadani dhe Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralët e FSK-së, përfaqësues të KFOR-it, NALT-it, atashe ushtarakë, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, familjarë dhe mysafirë të pranishëm.

Oficeri i NALT-it, Mark Theobald ligjëroi për kërkim-shpëtim në male

Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim Shpëtim në Pomozotin, para studentëve pjesëmarrës të Kursit të avancuar (niveli 3) për kërkim-shpëtim në male, më 12 mars 2018, ka ligjëruar ish oficeri i Britanisë, z. Mark Theobald. Studentët dhe i gjithë stafi, dëgjuan me vëmendje përvojën e z. Theobald rreth teknikave të mbijetesës në xhungël dhe mënyrën e aplikimit në mjedise sfiduese dhe në rast të kërkim shpëtimit malor. Me fokus të veçantë z. Theobold foli për një eksperiencë rreth një grupi ekspeditës të vitit 1994. Ky grup kishte humbur në një zonë të xhunglës malore në Malajzi, të plagosur, pa ushqim dhe ujë. Ai shpjegoi në detaje përpjekjet e ekipit të kërkim-shpëtimit në terren përfshirë angazhimin e helikopterit për të lokalizuar anëtarët e grupit të zhdukur. Gjithashtu, gjerësisht u diskutuan mësimet e nxjerra dhe të mësuara nga ekspedita e dështuar. Pjesëmarrësit e kursit kanë përfituar shumë nga përvoja e ligjëruesit të ftuar. Shpalosja e kësaj përvoje ishte një kontribut i çmuar në aftësimin e mëtejmë të tyre si profesionist të kërkim-shpëtimit. Mark Theobald është ish-oficer i Ushtrisë së Britanisë me përvojë 37 vjeçare. Ishte komandant në Shkollën e Trajnimit në Xhungël në Belizë. Dy vite instruktor me Ekipin e Ushtrisë së Britanisë në Brunei. Është i specializuar për trajnimet në xhungël. Tani ai shërben si zëvendësdrejtor i NALT-it, Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s, për FSK-në.



Në Brigadën e Mbështetjes Operacionale përfundoi gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë

Në ambientet e kazermës ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore, më 16.03.2018, është mbajtur ceremonia e garës për përzgjedhjen e ushtarit më të mirë në kuadër të Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO). Në ceremoni të pranishëm ishin: komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i BMO-së, gjeneral brigade Naim Haziri, zv. komandanti i BMO-së, kolonel Avdi Rraci, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, shefi i shtabit të BMO-së, nënkolonel Sami Hajrullahu, komandantët e batalioneve të BMO-së, nënkolonel Rifat Maloku-Batalioni i Logjistikës, nënkolonel Fidaim Elshani-Batalioni i Xhenios si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, u shpreh i kënaqur me mbajtjen e kësaj ceremonie të parë, pas marrjes së detyrës si Komandant i Forcave Tokësore. "Kam kënaqësinë që sot jam në mesin tuaj dhe dua t`ju përgëzoj për krejt angazhimet që keni bërë ju si Komandë e Mbështetjes së Operacioneve, për të organizuar këtë aktivitet që tashmë është bërë tradicional në njësitet e FSK-së, dhe gara e ushtarit më të mirë në nivel të FSK-së si aktivitet ndërkombëtar më i veçantë. FSK-ja ka krijuar kapacitete të mjaftueshme për të trajnuar dhe për ta përgatitur veten, për të qenë karshi forcave mike, por dhe forcave tjera, të cilat janë në rajon, apo me të cilat FSK-ja ka bashkëpunim të ndërsjellë".

Ndërsa, zv. komandanti i BMO-së, kolonel Avdi Raci, theksoi se "organizimi i këtyre garave ka për qëllim testimin e nivelit të përgatitjes fizike dhe psikike të personelit të brigadës sonë, që të jenë sa më të përgatitur për aktivitetet dhe garat tjera që na presin gjatë vitit". Në fund të ceremonisë u ndanë certifikata për pjesëmarrësit në garë dhe fituesit e tri vendeve të para. Vendi i parë i takoi tetarit Besnik Nebihu nga Regjimenti i Mbrojtjes Civile, i dyti tetarit Migjen Shala po ashtu nga Regjimenti i Mbrojtjes Civile dhe vendi i tretë tetarit Labinot Vuniqi nga Batalioni i Logjistikës.

Drejtori i NALT-it, gjenerali Ralf Hoffmann vizitoi Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së



Më datë 28.03.2018 në kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, përkatësisht në mjediset e Qendrës për Studime Universitare (QSU), ka qëndruar për vizitë drejtori i NALT-it (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s për FSK-në), gjeneral brigade Ralf Hoffmann së bashku me ekipin tij. Gjenerali Hoffmann u prit në QSU nga stafi udhëheqës i kësaj qendre, i cili e njoftoi me misionin dhe aktivitetet që zhvillohen në këtë qendër studimi. Ndërkaq, gjenerali Hofmman së bashku me ekipin e tij, pas takimit të shkurtër që zhvilloi me stafin e QSU-së, të cilit i shprehu gatishmërinë për ta ndihmuar kudo që paraqitet nevoja, vizituan edhe infrastrukturën përcjellëse të QSU-së, përfshirë: objektin e akomodimit të kadetëve, dhomat e studimit, sallat e përgatitjes fizike dhe zyrat e punës.

Në fund të takimit, gjenerali Hoffmann takoi edhe disa nga kadetët e QSU-së, me të cilët shkëmbyen mendime lidhur me jetesën e kadetëve në përgjithësi dhe përgatitjen e tyre profesionale si oficer të ardhshëm. Gjenerali u shpreh mjaft i kënaqur me vizitën dhe njohjen nga afër të aktiviteteve që zhvillohen në QSU, duke treguar gatishmëri për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

Certifikohen kadetët e Kursit të avancuar për kërkim-shpëtim në male

Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, në kazermën "Evropianët e rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së në Pomozotin, më 23 mars, pas një trajnimi 3 javor, mjaft sfidues, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, pjesëmarrës në Kursin e avancuar (niveli i tretë) për kërkim-shpëtim në male. Në Kursin e avancuar janë realizuar temat: ngjitja malore, ngjitja me litar, navigimi malor dhe mbijetesa në male, kalimi i luginave dhe evakuimi i viktimave. Ekipet kanë qenë të përfshira në udhëheqjen e ekipeve të shpëtimit në kushte ekstreme, lokalizimin dhe sjelljen në vend të sigurt të njerëzve të humbur ose të lënduar.

Nga pjesëmarrësit është kërkuar të kenë një nivel të lartë të gjendjes fizike, pasi që rrugëtimi i tyre ka përshkruar kilometra të shumtë në mjedise malore. Element i ri i këtij kursi ishte edhe teknika e mbijetesës në kushte atmosferike të ftohta malore. Kadetët janë njoftuar jo vetëm se si të punohet në një mjedis të tillë, por edhe si ta kuptojnë dhe mbrojnë mjedisin ku veprojnë ata. Për t'u siguruar që njohuritë e pjesëmarrësve janë ndërthurur me ato të ekipeve të kombeve tjera për kërkim- shpëtimit në male, ata janë pajisur me njohuri për procedurat dhe praktikat ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit, siç është përdorimi i helikopterit për të lokalizuar dhe nxjerrë viktimat. Kualifikimi i kandidatëve në këtë trajnim lidhet jo vetëm me pjesëmarrjen në kurs, por edhe me udhëheqjen e ekipeve të kërkim-shpëtimit.

Në fund të kursit ju ndanë certifikatat kadetëve të suksesshëm: Hamit Hyseni, Adnan Krasniqi, Shaban Kurti, Sabri Berisha, Fatmir Gashi, Bajram Janova, Besart Krasniqi dhe Valon Zeneli.



Përfundojnë ushtrimet në bashkëpunim me instruktorë të Gardës Kombëtare të Ajovës

Nga data 27 shkurt deri më 02 mars 2018, janë realizuar: ushtrimi në tavolinë; ushtrimi në fushën e logjistikës dhe ushtrimi fushor i komunikimit „Pëllumbi-4". Qëllimi i këtyre ushtrimeve ishte që të arrihen standardet sa më të larta të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës; të përfitohet nga eksperiencat e ushtrisë amerikane; të dëshmohet funksionaliteti dhe profesionalizmi në këto tri fusha përkatëse.

Në ceremoninë e certifikimit të ushtrimit për logjistikë, ishin të pranishëm: zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Naim Haziri, shefi i Departamentit të Logjistikës së KFT-së, nënkoloneli Arbnor Zeneli, oficeri i specializuar për Logjistikë nga Garda Kombëtare e Shtetit të Ajovës, SHBA, W01 Leon B. Altman. Në përmbyllje të ushtrimeve janë realizuar edhe analizat pas-vepruese (APV) nga FSK-ja dhe nga Garda Kombëtare e Shtetit të Ajovës, ku u prezantua ecuria e ushtrimeve.

Të pranishmit u informuan për së afërmi më rrjedhën e këtyre ushtrimeve të cilat i paraprijnë ushtrimit fushor "Shqiponja 6". Zv. komandanti i KFT-së, gjeneral Hazrolli, falënderoi Ushtrinë Amerikanë për përkrahjen e vazhdueshme që është duke dhënë për FSK- në. Ai shtoi se "ky është një proces që nuk ka filluar sot, por shumë më herët dhe falë mbështetjes profesionale të ekipit të Gardës Kombëtare të Ajovës, ne me sukses jemi duke realizuar detyrat e përgjithshme. Me këtë rast në emrin e komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës e falënderoj shefin Altman, dhe ekipin e tij, dhe nëpërmes tyre Gardën Kombëtare të Ajovës dhe gjeneralin Orr. Ndërsa shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Naim Haziri tha se "sektori i komunikimit është njëri ndër sektorët më të rëndësishëm në realizimin e ushtrimit. Ndihmat e ofruara nga partnerët e sidomos nga SHBA-ja kanë ndikuar në ngritjen dhe profesionalizimin e këtij sektori, ku ne sot kemi pajisjet më moderne të komunikimit që përdoren për komandë dhe kontrolle në operacione të ndryshme".

Certifikohen pjesëtarë të FSK-së dhe Policisë së Kosovës për ndihmën e parë të avansuar

Në kazermën „Adem Jashari'' të Forcës së Sigurisë së Kosovës, më 30 mars u zhvillua ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së dhe Policisë së Kosovës. Ky certifikim i përket ciklit të dytë të trajnimit dyjavorë, me temë: „Menaxhimi i traumës taktike (Ndihma e parë e avancuar). Trajnimi është mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përkatësisht Zyra për Mbështetje Civile Ushtarake (CMSE). Trajnimi është zhvilluar nga instruktorët e Forcës së Sigurisë së Kosovës. U certifikuan 20 pjesëmarrës në trajnimin në fjalë, 15 oficerë policie të njësisë kufitare dhe 5 pjesëtar të FSK-së.



Në këtë ceremoni ishin të pranishëm: ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministri Burim Ramadani, ambasadori i SHBA-ve, Greg Delawie, komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjenerali Enver Cikaqi, zv. komandanti i KFT-së, gjenerali Xhevahir Geci, shefi i Departamentit mjekësor në MFSK, kolonel Dr. Xhevdet Tahiraj, si dhe oficerë të FSK-së, KFOR-it e mysafirë të shumtë.

Në fjalën e tij, ministri Berisha tha se "i përgëzoj pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në mesin e të cilëve janë edhe 3 pjesëtarë të komunitetit jo shumicë dhe pjesëtarët e FSK-së, të cilët përfunduan këtë trajnim dyjavorë në lëmine e mjekësisë. Gjithashtu i përgëzoj edhe trajnerët e FSK-së, të trajnuar më parë nga Ushtria Amerikane (Bondstill), sipas standardeve të NATO-s, gjithnjë të përkrahur nga Ambasada e SHBA-ve, institucion mik ky që ka ndihmuar edhe konkretisht me pajisje për nevoja të mbarëvajtjes së këtij trajnimi".

Ndërsa, ambasadori amerikan, Greg Delawie i përgëzoi organizatorët dhe instruktorët për angazhimin dhe kontributin në përfundimin me sukses të kursit. Ai gjithashtu theksoi se njohuritë dhe shkathtësitë e fituara shpresoj të mos i aplikoni asnjëherë: „Ju gjatë dy javëve të shkuara keni arritur t'i mësoni shkathtësitë thelbësore për menaxhimin e traumave edhe pse shpresoj që kurrë te mos jeni në pozitë që do t'ju duhet t'i përdorni këto shkathtësi. Tani, të gjithë dini si ta vlerësoni një pacient dhe ta trajtoni atë derisa të arrijë ndihma mjekësore, ju jeni të përgatitur për të shpëtuar jetë''.

Në kursin, Menaxhimi i traumës taktike në teori dhe praktikë, u zhvilluan disa prej temave si: Kujdesi taktik luftarak i viktimës; Kontrollimi i gjakderdhjes; Hapja dhe menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes; Trajtimi i plagëve shpuese në kraharor; Kërkesa për evakuim mjekësor; Zhvendosja taktike e viktimës; Evakuimi i viktimës me barelë; Imobilizimi i frakturave; Qasja venoze; Lëndimet nga të ftohtit / Lëndimet nga nxehtësia; Sulmi në zemër–defibrilatori (AED); Reanimimi kardiopulmunar (RKP); Sulmi në tru; Epilepsia; Astma; Inicimi i kartelës shëndetësore, etj.

Ministri dhe komandanti i FSK-së homazhe para arkivolit të tetar Shani Malokut

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, të cilët shoqëroheshin edhe nga atasheu ushtarak i SHBA-ve, në Kosovë, kolonel Feffrey Fisher, gjeneralë, oficerë, nënoficerë, ushtarë të FSK-së, si dhe kolegë të njësisë dhe punës së të ndjerit, në kazermën e FSK-së në Pomozotin, bënë homazhe para arkivolit të tetar Shani Malokut, si dhe i shprehën ngushëllime familjarëve të tetar Malokut.

Varroset me nderime tetari i FSK-së, Shani Maloku

Më 10 mars 2018, në fshatin e lindjes në Plloqicë të Komunës së Malishevës u varros me nderime pjesëtari i FSK-së tetar Shani Maloku. Në dhënien e lamtumirës së fundit ishin të pranishëm pjesëtarët dhe kolegët e Regjimentit të Mbrojtjes Civile - RMC, pjesëtarë të FSK-së si dhe familjarë dhe qytetarë të shumtë. Kjo ceremoni varrimi ishte e veçantë sepse bëhej varrimi i dy vëllezërve të vrarë Shani e Bahri Malokut. Para të pranishmëve fjalën lamtumirëse e mbajti komandanti i RMC-së, kolonel Shqip Haziri, i cili ndër të tjetra tha: "Në kohën e transformimit nga UÇK në TMK, Shani Maloku u radhitë në njësitë e Gardës Kombëtare të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës deri në janar të viti 2009. Në këtë periudhë kaloi me sukses testet, për të vazhduar në FSK si teknik laboratori në kompaninë e MKAB-së të Regjimentit të Mbrojtjes Civile. Po ndahemi përfundimisht dhe në mënyrë të pazakontë nga nënoficer Shani Maloku, ushtaraku, i cili barti mbi supe periudha të rëndësishme të historisë sonë, për të shërbyer me devotshmëri deri në fund të karrierës ushtarake, për të cilën i kishte vënë vetes qëllim". Në emër të shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, mbajti fjalë rasti Metush Kryeziu. Në emër të komunës fjalën e rastit e mbajti kryetari i Komunës së Malishevës Ragip Begaj. Në emër të familjes pjesëmarrësit i ka falënderuar Ajshe Maloku.



FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 68 • 10 Maj 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Zëvendës asistenti i Sekretarit Gjeneral të NATO-s, John Manza vizitoi MFSK-në

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, të shoqëruar nga zyrtarë dhe eprorë të lartë të Ministrisë dhe FSK-së, pritën më 13 prill 2018, një delegacion të lartë të NATO-s të kryesuar nga John Manza zëvendës asistent i Sekretarit Gjeneral të NATO-s, i cili shoqërohej në takim edhe nga zëvendës shefi i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NALT) MarkTheobald. Ministri Berisha gjatë takimit ka vlerësuar lart shkallën e bashkëpunimit me NATO-n si dhe ka falënderuar NALT-in për kontributin në MFSK dhe FSK, si dhe KFOR-in për bashkëpunimin e mirë. Po ashtu, Ai ka folur edhe për bashkëpunimin e mirë me shtetet fqinje, në veçanti me ato me të cilat kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi; suksesin e integrimit të komuniteteve pakicë në FSK, posaçërisht të komunitetit serb.



Ministri Berisha ka kërkuar që të ketë përkrahjen e NATO-s për anëtarësim të Kosovës në nismat rajonale të sigurisë. Më tej ministri Berisha ka folur edhe për përgatitjet që janë bërë rreth procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura.

Ndërkaq, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama e njoftoi delegacionin e lartë nga Brukseli me aktivitetet në FSK-së, si: sukseset e kadetëve në vendet e ndryshme të botës; sukseset e FSK-së në fushat operacionale; nivelin e stërvitjeve me standarde të NATO-s; pjesëmarrjen e FSK-së në trajnime dhe ushtrime fushore ndërkombëtare; përgatitjet për konferencën vjetore të prillit "FSK dhe partnerët"; përgatitjet për mbajtjen e ushtrimit fushor "Shqiponja-6", ku do jenë pjesëmarrëse edhe 12 shtete partnere të Kosovës.

Në fjalën e tij, gjeneral Rama theksoi se FSK-ja ka bërë të gjitha përgatitjet dhe planet për transformimin e FSK-së dhe pret vendimin politik. Si prioritet, komandanti i FSK-së, shtroi kërkesën që FSK-ja të jetë ofrues i sigurisë përmes Operacioneve të Mbështetjes së Paqes.

Nga ana e tij, zëvendës asistenti i Sekretarit Gjeneral të NATO-s,John Manza u shpreh i kënaqur me arritjet e FSK-së, duke thënë: "Ju keni bërë gjithçka në mënyrën e duhur. Si FSK, jeni përfaqësuar shumë lart nga performanca e kadetëve tuaj në akademitë ushtarake jashtë vendit. Keni bërë punë të shkëlqyer me integrimin e komuniteteve pakicë. Ndryshimet për transformimin e FSK-së, duhet të bëhen mbi bazën kushtetuese. Të jeni të fokusuar dhe përqendruar në arritjen e synimeve afatgjata".

Dy delegacionet u pajtuan që bashkëpunimi Kosovë-NATO të thellohet në fushat ku ekziston mundësia.

Në MFSK u mbajt konferenca „FSK dhe Partnerët"

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 26-27 prill 2018, u mbajt konferenca dy ditore „FSK dhe Partnerët" me pjesëmarrje të ambasadorëve dhe atasheve ushtarak të shteteve partnere.

Në hapjen e punimeve të Konferencës së 8-të, të organizuar nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, me këtë rast, tha:„-Forca e Sigurisë së Kosovës reflekton të vërtetën e Kosovës dhe kjo e vërtetë është që të gjithë ne, çdo qytetar i këtij vendi, të ndjehet si në shtëpinë e tij, qoftë shqiptar, serb, turk, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak.

Aspirata jonë është që t'i bashkohemi familjes së Aleancës Veriatlantike dhe t'i kontribuojmë paqes", tha kryeministri Haradinaj.

(vazhdon në faqen 4).



Shpallet ushtari më i mirë i FSK-së dhe ushtari më i mirë i garës ndërkombëtare-2018

Në Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore, më 27 prill 2018, u shpallën rezultatet e garës ndërkombëtare dhe të FSK-së "Ushtari më i mirë i vitit 2018". Në ceremoni ishin të pranishëm ministri Berisha, zv. ministri Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, si dhe atashe të shteteve partnere të FSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, tha se; kjo garë tashmë është bërë internacionale dhe qëllimi i saj është që të promovojë shpirtin garues të ushtarëve dhe të rrisë motivimin e tyre, si dhe shprehu admirimin që në këtë garë kanë marrë pjesë ushtarak nga tetë shtete partnere me gjithsej



17 garues. "Unë i falënderoj shtetet partnere, të cilat i janë përgjigjur pozitivisht ftesës për të marrë pjesë në këtë garë. Ju tashmë keni krijuar ura të bashkëpunimit dhe njëkohësisht keni krijuar lidhje shoqërore, e që është njëra ndër qëllimet kryesore të kësaj gare". Gjeneral Rama, duke iu drejtuar pjesëmarrësve të garës, tha: "Ushtarë të nderuar, ju duhet të ndjeheni krenar me arritjet e juaja, dhe kjo dëshmon se jeni të gatshëm për tu ballafaquar me sfidat që na vijnë në të ardhmen. Pa dyshim se ju jeni model i një ushtari të kompletuar dhe besoj se njohuritë tuaja do i ndani në njësitë ku ju shërbeni. Vetëm kështu, duke i ngritur standardet, ne ecim drejt përmirësimit dhe zhvillimit të Forcës".

Ndërsa, rreshtermajori i parë i FSK-së, Genc Metaj, tha se; gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë për vitin 2018, si në nivel të FSK-së, ashtu edhe atë ndërkombëtarë; është planifikuar, organizuar dhe ekzekutuar nga nënoficerët e FSK-së. Zbatimi i suksesshëm i një aktiviteti të tillë, është tregues më i mirë se kemi krijuar një Trupë profesionale të nënoficerëve. Dua t'i falënderoj vendet pjesëmarrëse, e në veçanti rreshter majorët për gatishmërinë për të dërguar ushtarët e tyre në këtë aktivitet. Ai shprehu mirënjohje për të gjithë garuesit ndërkombëtar dhe të FSK-së, për disiplinën e treguar, përkushtimin dhe profesionalizmin gjatë gjithë kohës.

Në fund u shpallën rezultatet e të dyja garave. Ushtari më i mirë i vitit 2018, në nivel të FSK-së, u shpall tetari Lorik Ramaj, BRSH, i dyti; tetari Berat Babaj, BRSH, dhe i treti ushtari Egzon Jashari, Brigada për Mbështetje Operacionale. Ndërsa fitues i garës ndërkombëtare "Ushtari më i mirë i vitit 2018" ishte ushtaraku nga Shqipëria, Vladimir Haxhijaj, vendin e dytë e zuri tetar Joery Hinssen dhe vendin e tretë, ushtari Aaron Braun nga Forcat e Armatosura të Kanadasë. Gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë në nivel të FSK-së, organizohet që nga viti 2014, këtë vit, u zhvilluar nga data; 23-27 prill 2018, ku ushtarë dhe nënoficerë nga të gjitha njësitë e FSK-së dhe nga vendet partnere pjesëmarrëse garuan së bashku dhe treguan përkushtim dhe profesionalizëm të lartë gjatë ekzekutimit të gjitha detyrave të parashtruara. Në këtë garë morën pjesë 22 garues nga FSK-ja dhe 17 garues ndërkombëtar nga: Shqipëria, Belgjika, Kanadaja, Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara tëAmerikës.

Ministri Rrustem Berisha priti ambasadorin e Francës Didier Chabert



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, më 5 prill 2018, priti në një takim zyrtar ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Francës në Kosovë, z. Didier Chabert.

Ministri Berisha, me këtë rast e ka falënderuar ambasadorin DidierChabert dhe përmes tij Sekretaren e Shtetit pranë Ministrisë së Armatave të Francës, zonjën Genevieve Darrieussecq, për pritjen që i ka bërë ministrit Berisha, gjatë vizitës zyrtare në Francë, në muajin shkurt të këtij viti. Ministri Berisha e ka njoftuar ambasadorin Chabert, me zhvillimet dhe të arriturat e përgjithshme të FSK-së; integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, përfaqësimin e lartë të gjinisë femërore në Ministri dhe FSK, si dhe për bashkëpunimin ndërkombëtar që ka FSK-ja, me NATO-n, KFOR-in, NALT-in, SHBA-të, shtetet anëtare të NATO-s dhe të atyre që aspirojnë të anëtarësohen në NATO. Gjithashtu, ministri Berisha e ka njoftuar ambasadorin Chabert, edhe me sfidat dhe zhvillimet rreth aktiviteteve për transformimin e FSK-së, në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Në takimin e përbashkët, ministri Berisha dhe ambasadori Chabert, konstatuan vullnetin e dyanshëm për zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit në mes Ministrisë sëFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Francës, duke marrë angazhimin për emërimin e atasheut ushtarak në Kosovë, si dhe pjesëmarrjen e ushtarakëve të Francës në kuadër të NALT-it (Ekipi Ndërlidhës Këshillues të NATO-s) në MFSK, dhe angazhimin e dyanshëm për thellimin e bashkëpunimit në fushat që janë në interes të përbashkët për të dyja ministrit dhe shtetet.

Nga ana e tij, ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chaver falënderoi ministrinë Berisha për pritjen, si dhe konfirmoi gatishmërinë e Francës dhe Ministrisë së Mbrojtjes për zhvillimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit në muajt në vazhdim, duke filluar me vizita të delegacioneve zyrtare, identifikimin e fushave të bashkëpunimit me interes të përbashkët për të dyja shtetet.

Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj qëndroi për vizitë në Ministrinë e Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për FSK-në, Shkëlzen Sylaj, me ftesë të ministrit të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, Mark Lancaster, më 3 prill 2018, ka vizituar Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut. Sekretari Sylaj, fillimisht ka zhvilluar takim me ministrin e Forcave të Armatosura, Mark Lancaster, pastaj me shefen e Politikës së gjerë evropiane, znj. Paula Hothersall si dhe me drejtorin e Sigurisë dhe Politikës Ndërkombëtare në Ministrinë e Mbrojtjes, Nick Gurr.

Sekretari Shkëlzen Sylaj e ka njoftuar ministrin Lancaster, me zhvillimet në FSK dhe situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, në takim u shpreh gatishmëria e të dy palëve për thellimin e bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Britanisë së Madhe. Theks i veçantë në takimin e sekretarit Sylaj, me ministrin Lancaster, iu kushtua përkrahjes së pjesëmarrjes së njësiteve të FSK-së, në misione jashtë vendit nën ombrellën e Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, nëpërmjet trajnimit dhe shkollimit të pjesëtarëve të FSK-së në akademitë prestigjioze të Britanisë së Madhe.

Gjatë takimeve në Ministrinë e Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj e ka falënderuar Mbretërinë e Bashkuar për përkrahjen me trajnime, shkollime dhe këshillime. Në të gjitha



takimet e zhvilluara u diskutua për mundësitë e mbështetjes me trajnime profesionale në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë edhe për shërbyesit civilë të MFSK-së, duke pasur parasysh modelin e integruar të MFSK-së, që është model i MM të BM.

Delegacioni nga Kosova dhe ai nga Britania konfirmuan gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit në mes dy institucioneve edhe në të ardhmen në fushën e trajnimeve për pjesëtarë të FSK-së dhe shërbyesit civilë në MFSK/FSK, duke pasur si objektiv që Kosova të jetë një ofrues i ardhshëm dhe kontribuues në sigurinë rajonale dhe botërore.

Në delegacionin e MFSK-së, ishin edhe sekretari personal i SP-së, Florin Hoxha, atasheu i FSK-së, major Beton Retkoceri, zv. drejtori i ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK-në (NALT), Mark Theoblad, këshilltari i komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, oficeri britanik, kolonel Paul Stainthorpe.

Mbahet seminari - Struktura ligjore e NATO-s dhe Partneriteti



Në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit "NATO-Kosovë", më 13-14 prill 2018, është mbajtur seminari me temën: "Struktura ligjore e NATO-s dhe Partneriteti". Seminari u organizua nga NATO në bashkëpunim me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. `

Në seminar morën pjesë zyrtarë të lartë të Ministrisë së FSK-së dhe stafit të lartë të FSK-së, si dhe përfaqësues të institucioneve të Qeverisë së Republikës të Kosovës.

Qëllimi kryesor i seminarit ishte njohja e strukturave të funksionimit të NATO-s, si dhe misionet e saj. Drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane në Ministrinë për FSK-në, Faruk Geci, njëherësh edhe koordinator i seminarit, tha se: "seminare të tilla do të zhvillohen gjatë tërë vitit, me qëllim dhe synim njohjen sa më të mirë të funksionimit të NATO-s".

Komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjenerali Enver Cikaqi priti zëvendës komandantin e KFOR-it, gjeneralin Janos Csombock

Në ambientet e kazermës ,,Adem Jashari" të FSK-së, në Prishtinë, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, priti më 10 prill 2018, në një takim zyrtar, zv. komandantin e KFOR-it, gjeneral brigade Janos Csombock, me bashkëpunëtorë. Gjenerali Enver Cikaqi, falënderoi gjeneralin Ssombock, për vizitën e parë, pas marrjes së detyrës së komandantit të KFT-së.

Gjenerali Csombock, me këtë rast, e uroi gjeneral Cikaqin, për detyrën e komandantit të Forcave Tokësore. Dy gjeneralët biseduan për vazhdimin e bashkëpunimit, ku në fokus të bisedimeve ishte realizimi i aktiviteteve të përbashkëta, siç është ushtrimi ,,Silver Sabre 2018-01" organizuar nga KFOR-i, ku do të marrin pjesë edhe institucionet vendore, si: FSK-ja, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave.

Ky ushtrim parashihet të realizohet në muajin prill, si dhe pjesëmarrja e KFOR-it në ushtrimin fushor të FSK-së, "Shqiponja 6", ku parashihet të marrin pjesë një numër i madh i pjesëmarrësve nga shumë vende të rajonit dhe më gjerë. Në takimin e përbashkët; dy gjeneralët vlerësuan lart bashkëpunimin e deritashëm dhe u zotuan se do të punojnë së bashku në ngritjen dhe thellimin e tij, edhe në të ardhmen, në të mirë të qytetarëve të vendit .



FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri dhe Komandanti i FSK-së në shënimin e manifestimit "Ditët e Shqipes" në Koshare


Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, morën pjesë në shënimin e përvjetorit të 19-të, të fillimit të Betejës së Koshares, në Koshare. Fillimisht, u intonua himni kombëtar si dhe u vunë kurora lulesh për nderë të jetës dhe rënies së dëshmorëve të kombit.



Me këtë rast, ministri Rrustem Berisha, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, krerët e shtetit, përfaqësuesit e institucioneve, veteranët, invalidët dhe familjet e dëshmorëve bëri një retrospektivë të luftës së Brigadës 138 „Agim Ramadani", të përpjekjeve dhe sakrificës për liri të luftëtarëve të saj: „Jemi mbledhur këtu, sikurse çdo vit, më 9 prill për të kujtuar të rënët dhe të gjallët, të cilët me pushkë në dorë e bënë atë që gjenerata të kësaj toke e kishin pritur për gati një shekull".

Ministri Berisha, duke qenë se ka komanduar gjatë Luftës së Ushtrisë Çlirimtare me këtë Brigadë, tha gjithashtu se: "këtu u luftua, nga Rrasa e Zogut deri në Morinë, nga Bjeshkët e Padeshit deri tek Livadhi i Shabanit e më tutje. U luftua ditë për ditë e natë për natë, në borë e në shi, e nën breshërinë e plumbave e predhave të armikut. Edhe sot, si ministër i FSK-së, dhe gjithmonë; pavarësisht ku do të na shpie detyra, në shërbim të atdheut, unë do të jem krenar që Zoti e deshi, të jem unë, në krye të kësaj beteje". Ky manifestim, për të 18-tën herë, u zhvillua në Koshare dhe u mbajt në kuadër të manifestimit, „Ditët e Shqipes".

Ministri dhe Komandanti i FSK-së, nderojnë me medalje këshilltarët e NATO-s, Mark Theobald dhe David Nikson





Ministri për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) Rrustem Berisha, më 25 prill 2018, organizoi ceremoni lamtumirëse me rastin e përfundimit të mandatit të zv. drejtorit të Ekipit Ndërlidhës të Këshilltarëve të NATO-s (NALT), Mark Theobald dhe shefit të këshilltarëve ushtarak, kolonelin nga SHBA-të, David Nikson.

Ministri Berisha falënderoi zv. drejtorin Theobald dhe kolonelin Nikson, për punën dhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm gjatë mandatit të tyre në MFSK/FSK. "Unë nuk e kam pasur fatin që tërë kohën të punoj me ta, por prej momentit kur kam filluar detyrën, kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm, dhe jam i bindur se do të na mungoni. Çdo herë llogaritni që në Kosovë jeni të mirëseardhur dhe me kënaqësi do ju presim, sepse puna e juaj dhe angazhimi juaj është suksesi i FSK-së, në përgjithësi".

Edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama vlerësoi lartë bashkëpunimin e zv. drejtorit të NALT-it, z. Theobald dhe kolonelit Nikson, për punën dhe kontributin e tyre në MFSK dhe FSK. "Unë i falënderoj për angazhimin e tyre dhe punën që kanë bërë gjatë kësaj kohe dhe falë përkrahjes së tyre, ne kemi arritur progres dhe na vjen keq që misioni i tyre po përfundon. Ju dëshiroj së pari shëndet në jetë dhe familje e po ashtu edhe punë të mbarë.

Ne gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe sfida të cilat falë këshillave tuaja i kemi kaluar më lehtë". Kurse zv. drejtori i Ekipit Ndërlidhës të Këshilltarëve të NATO-s, z. Theobald dhe koloneli Nikson, u shpreh shumë të lumtur me progresin e FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënantë Rrahman Rama dhe sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Shkëlzen Sylaj, para ceremonisë kanë mbajtur takime të ndara me zëvendësdrejtorin e Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NALT) Mark Theobald, në prag të përfundimit të misionit të tij në Republikën e Kosovës.

Në ceremoninë lamtumirëse ishin drejtues të lartë të MFSK-së, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së, këshilltarët e NALT-it, si dhe ushtarak dhe civil nga stafi ndërkombëtar që bashkëpunojnë me MFSK-në dhe FSK-në.

FSK-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Vetëdijesimit nga minat

Forca e Sigurisë së Kosovës së bashku me organizatat ndërkombëtare për deminim që veprojnë në Kosovë, më 4 prill 2018, në Pejë, shënuan Ditën Ndërkombëtare të Vetëdijesimit të rrezikut nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera. Në shënimin e kësaj ngjarje morën pjesë: Shkolla ndërkombëtare e eliminimit të mjeteve të pashpërthyera (EOD) në Kosovë, MAT-Kosova, HALO-Trust dhe NPA.

Të pranishëm ishin edhe gjeneral brigade Nazmi Brahimaj-drejtor i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve të MFSK-së, gjenerali Randy Powell-shef i Shtabit të KFOR-it, koloneli Nick Ducich-komandant i KFOR-it për Lindje në Bonstell, Ahmet Sallova-drejtor i Qendrës Koordinuese për Deminim në MFSK, si dhe përfaqësues të KFOR-it, Policisë së Kosovës dhe organizatave joqeveritare që veprojnë në Kosovë.

Në hapje të këtij organizimi, drejtori i Qendrës Koordinuese për Deminim në MFSK, Ahmet Sallova, falënderoi SHBA-të për përkrahjen dhe ndihmën e vazhdueshme për Kompaninë e Deminimit të FSK-së, si me pajisje ashtu dhe trajnime dhe të gjithë donatorët tjerë, siç janë: Zvicra, Norvegjia, Holanda, Belgjika etj. Ai theksoi rrezikun e vazhdueshëm që ekziston nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera në nivelin global dhe në Kosovë, duke thënë se "Zonat e minuara nuk përbëjnë rrezik vetëm për jetën e banorëve, por vështirësojnë edhe gjendjen ekonomike, për shkak të pamundësisë qoftë për punimin e tokave bujqësore apo edhe për



mos shfrytëzimin e zonave malore. Prandaj, evitimi i rrezikut nga minat dhe mjetet tjera eksploziveve është një parakusht për rindërtimin e vendit dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe ekonomike".

Zoti Sallova foli edhe për sukseset e ekipeve të deminimit të FSK-së dhe bashkëpunimin me organizatat tjera ndërkombëtare si: HALO Trust dhe NPA, të cilat janë duke krijuar një mjedis të sigurt në fushat e rrezikuara, duke mundësuar zhvillimin e jetës normale në Kosovë. "Këto rezultate na bëjnë krenarë për punën e shkëlqyer që është duke u bërë nga ekipet e deminimit të FSK-së. Falë punës së tyre, janë shpëtuar shumë jetë njerëzish dhe njëkohësisht është kthyer një numër i madh i tokave komuniteteve të ndryshme për shfrytëzimin e tyre.

Edhe përkundër pastrimit të shumë fushave të rrezikshme të minuara në Kosovë kanë mbetur edhe 98 zona të afektuara nga minat apo bombat kasetore".

Zotëri Sallova, në fjalën e tij, shpalosi disa tregues të rezultateve: "Prej fillimit të operacioneve të deminimit, pra që nga viti 1999, janë pastruar 51,216, 184 metra katrorë dhe janë gjetur dhe asgjësuar 88,895 mina dhe mjete eksplozive të pashpërthyera. Me gjithë këto rezultate nuk duhet të harrojmë faktin se që nga koha e luftës e deri më sot, 117 persona kanë humbur jetën si pasojë e minave dhe mjeteve tjera eksplozive dhe 463 veta kanë marrë lëndime të rënda trupore".

Në fund u bë edhe prezantimi i pajisjeve të deminimit dhe të arriturave të përgjithshme të organizatave pjesëmarrëse në Kosovë.

Në MFSK u mbajt konfere

(vijon nga ballina)



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 26 -27 prill 2018, u mbajt konferenca dy ditore „FSK dhe Partnerët" me pjesëmarrje të ambasadorëve dhe atasheve ushtarak të shteteve partnere.

Në hapjen e punimeve të Konferencës së 8-të, të organizuar nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, fillimisht shprehu falënderim për miqtë ndërkombëtarë të cilët e ndihmuan Kosovën në kohërat kritike. Ai, pos tjerash, me këtë rast, tha: „FSK-ja reflekton të vërtetën e Kosovës dhe kjo e vërtetë është që të gjithë ne, çdo qytetar i këtij vendi, të ndjehet si në shtëpinë e tij, qoftë shqiptar, serb, turk, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak. Sot, jemi në një institucion, që është shtëpia e të gjithëve. Aspirata jonë është që t'i bashkohemi familjes së Aleancës Veriatlantike dhe t'i kontribuojmë paqes", tha kryeministri Haradinaj, duke shtuar se tranzicioni i Forcës së Sigurisë dhe mandati kushtetues i saj, nuk do të ndërrojë themelin e shtetit tonë dhe misionin e vizionin e shoqërisë sonë".

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha, në fjalën e hapjes së punimeve të konferencës, pasi falënderoi të gjithë partnerët e FSK-së, për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme drejt arritjes së synimeve të Ministrisë dhe FSK-së, tha se Konferenca „FSK dhe Partnerët" ka për qëllim harmonizimin e aktiviteteve me partnerët, me synim të mbështetjes së nevojave të FSK-së, si dhe koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta në rrugëtimin e Republikës së Kosovës drejt integrimeve Euro-Atlantike. „Duke i paraqitur para jush kërkesat dhe nevojat tona, në mënyrë që ta shfrytëzojmë sa më racional angazhimin tonë në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, ne kemi për qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë së FSK-së me ushtritë e vendeve partnere dhe atyre të NATO-s".

Gjatë konferencës u bë prezantimi i të arriturave, sfidave dhe kërkesat për vazhdimin e mbështetjes nga partnerët edhe në të ardhmen. Ministri Berisha, numëroi disa prej të arriturave kryesore të institucionit; si rritja e besueshmërisë në veri të vendit, integrimi me sukses i komunitetet jo shumicë, barazia gjinore, bashkëpunimi me Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK (NALT) dhe vendet partnere, shpalosi edhe disa prej synimeve



të FSK-së për të ardhmen; sikurse është anëtarësimi i plotë në iniciativat rajonale, qasje adekuate për vendosjen e kontakteve me vendet që ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe partnerëve tjerë ndërkombëtar si dhe, që FSK-ja të mos të jetë vetëm konsumues i sigurisë dhe paqes, por të jetë edhe kontribuues pro aktiv i saj".

Ministri Berisha foli edhe procesin e transformimit. „Ne, si FSK kemi

Në kazermën "Evropianët e Rinj" në Pomozotin

U mbajt ushtrimi i përbashkët "Shpata e Argjendtë-18"



Forca e Sigurisë së Kosovës, KFOR-i, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Policia e Kosovës, më 27 prill 2018, pas demonstrimit të aktiviteteve përfundimtare, përfunduan me sukses Ushtrimin fushor "Shpata e Argjendtë 18", në kazermën "Evropianët e Rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) të FSK-së në Pomozotin.

Për t'i përcjell demonstrimet përfundimtare të pranishëm, ishin; Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Cuoci, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, drejtori i këshillit të Sigurisë Kombëtare, Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, si dhe gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, EULEX-it dhe Policisë së Kosovës.

Me këtë rast, komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi pasi përgëzoi të gjitha institucionet dhe agjencitë që planifikuan dhe ekzekutuan ushtrimin e përbashkët "Shpata e Argjendtë 2018" tha se ky ushtrim ka hy në kalendarin e ushtrimeve të FSK-së duke rikujtuar fillimet e zhvillimit të këtij ushtrimi kur FSK-ja ka qenë pjesërisht e angazhuar. "Ku ushtrim rrit ndërveprueshmërinë e FSK-së me institucionet dhe agjencitë tjera, duke i njohur më mirë procedurat e njëra tjetrës. Gjithashtu, u jep mundësi pjesëtarëve të FSK-së që duke punuar krah për krah me kolegët e tyre nga KFOR-i, institucionet dhe agjencitë tjera, të shkëmbejnë përvojat dhe të operojnë në ambient shumëkombësh".

Nga ana e tij, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Cuoci tha se qëllimi kryesor i këtij ushtrimi është që Forca e Sigurisë së Kosovës të trajnohet së bashku me EULEX-in, Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, Policinë e Kosovës në komandim, kontroll dhe çështje të koordinimit që kanë të bëjnë me planifikim dhe ekzekutim të operacioneve në reagim ndaj fatkeqësive në Kosovë në përgjithësi dhe skenarë me trazira civile në kuadër të konceptit të reaguesit të parë, dytë dhe të tretë.

"Qëllimi tjetër i ushtrimit është të demonstrojë që organizatat e sigurisë së Kosovës, në shkallë të gjerë janë duke përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme aftësitë e tyre, dhe janë duke bërë përpjekje për përmirësimin e taktikave, teknikave dhe procedurave të përbashkëta për punë të efektshme së bashku dhe në përmbushjen e roleve respektive".

Të gjithë të pranishmit patën mundësinë të përcjellin nga afër operacionet e ekzekutuara me sukses nga institucionet dhe agjencitë e sigurisë dhe emergjencave në Kosovë. Ushtrimi i përbashkët fushor "Shpata e Argjendtë 2018, është një ushtrim i bazuar në Planin e Reagimit Kombëtarë me anë të cilit testohen kapacitetet intervenuese të reaguesve të parë, dytë dhe të tretë. Ushtrimi "Shpata e Argjendtë 2018", është tregues i mirë i bashkëpunimit të FSK-së me institucionet dhe agjencitë tjera në Kosovë.



enca „FSK dhe Partnerët”



bërë përpjekje të vazhdueshme që procesi i Transformimit të ndodhë përmes ndryshimeve kushtetuese duke qenë të përkushtuar që pjesë e këtij procesi të jenë të gjitha komunitetet jo shumicë, në këtë rast dhe komuniteti serb. MFSK i ka realizuar të gjitha aktivitetet e parapara sipas planit të veprimit, ndërsa pjesën tjetër do ta realizojmë pas marrjes së vendimit për Transformim”.

Në fund, ministri Berisha, tha se: „përkushtimi ynë është që edhe në të ardhmen të vazhdojmë me përgatitjen e FSK-së, për tranzicion dhe kërkojmë mbështetjen dhe ndihmën e juaj, që edhe Lista Serbe, të jetë pjesë e këtij procesi”.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha: „Pa mbështetjen tuaj, Forca e Sigurisë së Kosovë nuk do të ishte këtu, ku është sot. Në organizatën tonë kultivojmë tri principe; atë të udhëheqjes, marrëdhënies dhe miqësisë”. „Ne sot këtu, së bashku me atashetë e vendeve mike kemi një ditë të gjatë dhe do t’i koordinojmë të gjitha aktivitetet tona, kërkesat dhe nevojat për të ardhmen”.

Ndërsa, koloneli Jeton Dreshaj, shef i kabinetit të Komandantit të FSK-së, paraqiti ekspozenë „FSK, Kredibile, Gjithëpërfshirëse dhe Gatshme”, me të cilin paraqiti disa prej të arriturave, bashkëpunimeve, sukseseve në shkollim edhe trajnime jashtë vendit, etj. Gjatë sesionit të parë të konferencës, folën edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Cuoci, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Ralf Hoffmann, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Turqisë dhe Kroacisë.

Konferenca vazhdoi me sesionet e punës gjatë ditës së parë, ndërsa në ditën e dytë, pjesëmarrësit e konferencës vizituan operacionet përfundimtare të ushtrimit të përbashkët me KFOR-in „Shpata e Argjendtë 18” në kazermën „Evropianët e rinj” në Pomozotin.

Në konferencë morën pjesë edhe zv. ministrat Burim Ramadani dhe Agim Çeku, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatori Cuoci, si dhe ambasadorë të vendeve mike dhe partnere, atashetë ushtarakë të akreditуar për Kosovë nga Shqipëria, Belgjika, Bullgaria, Kanada, Republika e Çekisë, Francës, Hungarisë, Italisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Turqisë, Mbretërisë së Bashkuar, SHBA-ve, përfaqësues nga Presidenca, Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, KFOR-i, nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave.



Ministri dhe komandanti i FSK-së kanë çmuar lartë angazhimin e ekipeve në operacionin e kërkim-shpëtimit në lumin Lepenc

Ministri dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha dhe gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 30 prill dhe 1 maj 2018, kanë vizituar aksin rrugor Kaçanik-Hani i Elezit, vend aksidentin e dy policive të Kosovës, në përkrahje të Njësisë së Kërkim-Shpëtimit në Ujëra të FSK-së, të cilët, që nga data 29 prill 2018, kanë zhvilluar operacionin e kërkimit të dy pjesëtarëve të Policisë së Kosovës; Malsor Dashi dhe Armend Trena. Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, gjatë vizitës së tyre i kanë mbështetur dhe inkurajuar specialistët e FSK-së, të cilët me vetëmohim dhe profesionalizëm kanë kryer detyrën, në rrethana të jashtëzakonshme, së bashku edhe me ekipet tjera të përfshira në operacion nga institucione dhe agjenci të ndryshme të specializuara në fushën e kërkimit në ujëra.

Me vendim të ministrit Rrustem Berisha dhe me urdhër të Komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës, Njësia e Kërkim-Shpëtimit në Ujëra dhe Male, vazhdoi operacionin e kërkimit të dy pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, për dhjetëra ditë me radhë, në lumin Lepenc, deri në gjetjen e trupave të pajetë të dy policëve, Dashi dhe Trena. Njësitet e kërkim-shpëtimit të FSK-së, kanë kontrolluar rrjedhën e lumit, si dhe në tërësi shpatin e malit-vendin e aksidentit në tërë sipërfaqen e tij.



Njësia e Kërkim-Shpëtimit në Ujëra e Task Forcës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, në ditën e gjashtë të operacionit kanë gjetur trupin e pajetë të policit Malësor Dashi, ndërsa në ditën e nëntë edhe trupin e policit të dytë, Armend Trena. FSK-ja është e përkushtuar që me kapacitetet e saj profesionale të vazhdojë angazhimin e saj në operacione të ndryshme duke u dalë në ndihmë institucioneve dhe të gjithë qytetarëve të vendit, në gjithë territorin e Kosovës. FSK-ja, në këtë operacion ka dëshmuar profesionalizëm, përkushtim dhe vetëmohim gjatë kryerjes së detyrave.





Në Komandën e Forcave Tokësore përfundoi trajnimi „Operacionet Civilo-Ushtarake”

Në kazermën „Adem Jashari“ të Komandës së Forcave Tokësore, më 13 prill 2018, është mbajtur ceremonia e përfundimit të trajnimit „Operacionet Civilo-Ushtarake”, i realizuar nga instruktorë të Zyrës për Mbështetje Civile-Ushtarake të ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Në ceremoni merrnin pjesë: komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale, gjeneral brigade Naim Haziri, komandanti i Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza, nënkolonel Milaim Musliu, udhëheqësi i zyrës për mbështetje Civilo-Ushtarake të ambasadës së SHBA-ve, kapiten Justin Bauer. Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral Cikaqi, në fjalën e tij, pasi falënderoi ambasadën Amerikane për mbështetjen e vazhdueshme dhe instruktorët për realizimin me sukses të këtij trajnimi, tha: „Duke parë rëndësinë që ka ky trajnim, në misionin aktual që ka FSK-ja, por edhe në të ardhmen; i kemi kushtuar një fokus të veçantë kësaj fushe”.

Ndërsa, udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Civilo-Ushtarake të ambasadës Amerikane, kapiteni Bauer, pos tjerash tha: „Për gjatë dy javëve, kemi realizuar trajnimin “Operacionet Civilo–Ushtarake”, në të cilin jemi munduar të japim instruksione për çështjet civilo-ushtarake dhe për shkathtësitë që duhet t’i posedojë një lider kyç në operacione të tilla. Ky trajnim është realizuar në teori dhe praktikë, duke i vizituar institucionet qendrore dhe ato lokale, me qëllim të marrjes së shkathtësive për të qenë në gjendje për të vlerësuar aspektet ushtarako civile. Ju me punën tuaj, do të jeni shembull për institucionin dhe të qeverinë tuaj”. Kapiteni Bauer, më tej shtoi: „FSK ka një bashkëpunim të shkëlqyer me Ambasadën Amerikane, përkatësisht me Zyrën e Elementit Mbështetës Civilo-Ushtarak dhe falë këtij bashkëpunimi është realizuar trajnimi “Operacionet Civilo-Ushtarake”. Trajnimi është zhvilluar në tri pjesë; në pjesën teorike, praktike dhe në fitnes fizik.

Qëllimi i tij, ka qenë zhvillimi i njohurive të pjesëtarëve të FSK-së, për marrëdhëniet civilo-ushtarake. FSK-ja në vazhdimësi është mbështetur nga ambasada Amerikane në Kosovë, në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, në të gjitha fushat. Në kuadër të këtij bashkëpunimi është realizuar edhe trajnimi në fjalë. Pjesë e këtij trajnimi kanë qenë 14 pjesëtarë të FSK-së, të cilët, që nga data: 03-13.04.2018, kanë zhvilluar trajnimin praktik dhe teorik për operacionet civilo–ushtarake, duke u fokusuar në temat me rëndësi të aspektit civilo-ushtarak. Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Zyrës së Elementit Mbështetës Civilo-Ushtarak të Ambasadës Amerikane, që nga viti 2013, me Njësinë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza të FSK-së, janë realizuar trajnime të ndryshme, si: Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake, Vlerësim të rreziqeve, Dhënien e ndihmës së parë dhe Evakuimin mjekësor në fushëbetejë.

Në kuadër të bashkëpunimit me Zyrës së Elementit Mbështetës Civilo-Ushtarak të Ambasadës Amerikane është bërë edhe vlerësimi real i rreziqeve në territorin e Republikës së Kosovës, ku është bërë vlerësimi i infrastrukturës hekurudhore dhe rreziqe tjera që mund t’u kanosen qytetarëve të Kosovës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë realizuar edhe disa mbështetje dhe operacione humanitare për komunitetet në Kosovë.

Takim i përbashkët FSK-NALT

Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) nën kryesimin e komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 20 prill u zhvillua takimi i dytë zyrtar, në mes lidershipit të FSK-së dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s(NALT) për Ministrinë dhe FSK-në.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, fillimisht theksoi rëndësinë e këtij takimi ndërmjet udhëheqësve të FSK-së dhe NALT-it, si organizatë dhe mekanizëm që punojnë shumë ngushtë bashkërisht, si dhe me një koordinim të vazhdueshëm në të mirë të zhvillimit dhe avancimit të FSK-së, e gjithashtu për rëndësinë e këtij bashkëpunimi me NALT-in, si dhe avancimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit me KFOR-in. Drejtori i NALT-it, gjenerali Hoffmann, në fjalën e tij u interesua rreth pozicionit aktual të



FSK-së, aktiviteteve dhe planeve për të ardhmen.

Ndërsa, zëvendës komandanti i KFOR-it, gjenerali Csombock u fokusua në ndërveprimet e suksesshme ndërmjet KFOR-it dhe FSK-së, sidomos në ushtrimet e përbashkëta fushore.

Ky ishte takimi i dytë me radhë i udhëheqësve të FSK-së dhe NALT-it, i cili mbahet me qëllim informimi, koordinimi dhe harmonizimi të aktiviteteve të përbashkëta.

Oficerë të Kursit të Lartë të Republikës së Shqipërisë vizituan FSK-në



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Komandën e Forcave Tokësore, më 20 prill 2018, për një vizitë pune, bazuar në programin mësimor dhe planin e aktiviteteve për “Kursin e Lartë të Oficerit” (KLO) qëndruan kursantët e Akademisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

Kursantët fillimisht vizituan Komandën e Forcave Tokësore (KFT), ku u pritën nga komandanti i saj, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili me këtë rast, i ka përshëndetur, kursantët, për vizitën mësimore dhe njëherësh i ka njoftuar me të arriturat e përgjithshme të Komandës së Forcave Tokësore.

Kurse në Ministrinë për FSK-në, kursantët e Akademisë së Mbrojtjes të Shqipërisë u pritën nga oficerë të lartë të Departamentit për Transformim, Standardizim dhe Modernizim të MFSK-së. Nënkoloneli Haki Hoti, ushtrues detyre i këtij Departamenti, përmes një prezantimi i njoftoi kursantët me të arriturat e përgjithshme; që nga themelimi i FSK-së, plotësimi i kapaciteteve operacionale, shkollimet, trajnimet, bashkëpunimin ndërkombëtar, rajonal si dhe për procesin e transformimit të FSK-së, në FAK. Interesimi i kursantëve për ligjëratën e nënkolonel Hotit, ishte i madh, kjo u pa në pyetjet e shumta që iu drejtuan atij, e që kishin të bënin me të ardhmen e FSK-së.

Certifikohen kadetët e Kursit bazik për kërkim-shpëtim në male

Kursi është projektuar për t’i njoftuar kadetët rreth ngjitjes malore, ngjitjes me litar, navigimit malor dhe evakuimit të viktimave. Gjatë këtij kursi tre-javor, pjesëmarrësit kanë mësuar mënyrat e ndryshme të përdorimit të litarit, llojet e krijimit të nyjave në litarë, si dhe ankorimin e litarit. Ata, gjithashtu mësuan për rëndësinë e kujdesit të mirëmbajtjes së pajisjeve. Kjo u theksua veçanërisht gjatë skenarëve ku studenteve iu kërkua të kujdeseshin për veten dhe viktimat. Ndihma e parë mjekësore dhe kujdesi ndaj viktimave janë pjesë kyçe e trajnimit, e veçanërisht kujdesi ndaj viktimave që rezultojnë si pasojë e motit të ftohtë dhe lëndimeve. Kadetët gjatë trajnimit praktikuan shumë skenarë me teknika të ndryshme ku përfshihen; trajtimi i menjëhershëm dhe evakuimi mjekësor i viktimave. Paraqitja e studentëve si në pjesën praktike ashtu edhe atë teorike është vlerësuar gjatë tërë trajnimit. Trajnimi arrin kulmin zhvillimor me një sërë testesh praktike duke u përmbyllur me testin me shkrim. Për një numër të madh të kadetëve, kjo ishte hera e parë që ata kanë ushtruar në një lartësi kaq ekstreme. Mirëkuptimi dhe besimi i lartë në pajisjet e tyre ishin faktorë mjaftë të rëndësishëm.

Drejtori i Qendrës së Trajnimit, gjatë fjalës së tij, të mbajtur me këtë rast, u shpreh : “Tejkalimi i frikës personale dhe fuqia e



karakterit luan një rol të madh në kurset që ne ofrojmë. Instruktorët tanë janë të shkëlqyeshëm dhe në gjendje të vlerësojnë se nxënësit zhvillohen me shpejtësi të ndryshme. Ky ka qenë një kurs i mirë dhe jam shumë i kënaqur me rezultatet. Suksesi në këtë trajnim i kualifikon kandidatët për të qenë pjesë e ngjarjeve të kërkim-shpëtimit malor. Me kohë, pas arritjes së një përvojë më të madhe, ata do të ftohen në Kursin e nivelit të dytë”.

Gjermania i dhuroi FSK-së manualet për mirëmbajtjen e automjeteve taktike Mercedes

Gjermania në vazhdimësi ka mbështetur Forcën e Sigurisë së Kosovës në forma të ndryshme; me donacione dhe përgatitje profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Më17 prill 2018, në Komandën e Forcave Tokësore është bërë pranimi i Manualeve, për mirëmbajtjen e automjeteve taktike Mercedes, të punuara dhe të përkthyera në gjuhën shqipe nga KFOR-i gjerman.

Me rastin e dorëzim–pranimit të pranishëm ishin: komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade, Enver Cikaqi, UD i shefi i Shtabit të KFT-së kolonel Hasan Hoxha, atasheu ushtarak gjerman i akreditуar për Kosovë, rezident në Bosnje e Hercegovinë, koloneli Martin Herrmann,



këshilltari gjerman për logjistikë, koloneli Armin Dausch, shefi i këshilltarëve të NALT-it, koloneli Nicson dhe oficerë nga të gjitha njësitet e FSK-së. Komandanti i KFT-së, gjenerali Enver Cikaqi, me këtë rast, ka falënderuar Qeverinë Gjermane për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë dhe po i jep FSK-së.

"Me pranimin e donacionit të automjeteve, gjithë këto vite të gjitha njësitë janë përballur në shumë vështirësi, andaj pajisja me mjetet apo veglat speciale për punë për këto automjete dhe manualet për mirëmbajtje do të na lehtësojnë punën si në mirëmbajtje ashtu edhe në përdorimin sa më efikas të tyre", tha gjeneral Cikaqi.

Ndërsa, koloneli Dausch, njoftoi pjesëmarrësit me rëndësinë e manualeve për përdorimin sa më efikas të automjeteve taktike Mercedes, të cilat janë donacion nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës Federale Gjermane, që nga viti 2009. "Këto nuk janë automjete të zakonshme, përdoren për terrene të vështira malore".
Një elaborim në detaje të këtyre manualeve, se si të përdoren dhe se çka përmbajnë në hollësi e ka bërë rreshtermajori Stefan Stieber. Kurse, atasheu ushtarak gjerman, koloneli Martin Herrmann, duke folur për rëndësinë e këtyre manualeve tha; "tash e sa vite, kemi një bashkëpunim të mirë me FSK-në. I kemi dhuruar një donacion, vite më parë, me automjete taktike për ta mbështetur FSK-në.

Dhurimi i donacionit nuk ka qenë ndonjë problem, por se si të përdoren ato dhe si të mirëmbahen, është një sfidë në vete. Trajnimi i personelit për mirëmbajtje dhe donacioni me pajisjet speciale për mirëmbajtje kanë qenë hapat e mëtejmë e që mbetet punë për të vazhduar në implementimin e këtyre manualeve me të gjitha njësit.

Në Komandën e Forcave Tokësore u mbajt punëtoria e sigurisë kibernetike



Në kazermën ,,Adem Jashari" të FSK-së, nga data 16-20 prill 2018, është mbajtur punëtoria e gjashtë e sigurisë kibernetike, realizuar nga oficerë të Gardës Ajrore Kombëtare të Iowa-s, të SHBA-ve. Në punëtori morën pjesë 17 oficerë dhe nënoficerë nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Në ceremoninë përmbyllëse të pranishëm ishin: Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, nënkoloneli Lawrence Yazzie, majori William McElvain nga Garda Ajrore Kombëtare e Iowa-s, dhe shefi i Departamentit të G6-të të KFT-së, nënkolonel Gyrner Murati, i cili në hapje të këtij aktiviteti, shpjegoi në pika të shkurta ngjarjet që janë realizuar gjatë gjithë javës në fushën e mbrojtjes kibernetike.

Komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, falënderoi të pranishmit dhe në veçanti oficerët dhe nënoficerët nga Iowa, për bashkëpunimin dhe ndihmën që po japin për ngritjen dhe profesionalizimin e pjesëtarëve të FSK-së, si dhe për mbështetjen e pakursyer të Gardës Kombëtare të Iowa-s dhe personalisht gjeneralit Timothy Orr, tha: "U jemi mirënjohës për punën tuaj, për atë që po bëni duke bartur përvojat tuaja tek pjesëtarët tanë, duke shkëmbyer përvojat në aspektin e mbrojtjes kibernetike, ju keni ndihmuar FSK-në, në ngritjen e një aseti mjaft të rëndësishëm, që për ne është fushë e re". Duke iu drejtuar pjesëtarëve të sapo certifikuar, gjeneral Cikaqi, tha: "ju jeni bartës të këtij aseti, dhe me që, jemi afër realizimit të ushtrimit fushor ,,Shqiponja 6", kërkoi nga ju, që mësimet e mësuara nga e kaluara dhe trajnimet e mara tani, të jeni sa më profesional në realizimin e ushtrimit të tanishëm".

Ndërsa, nënkoloneli Yazzie, bëri një prezantim të punës së përbashkët gjatë kësaj jave, duke falënderuar për mirëpritjen, që ju është bërë në Kosovë, e veçanërisht në FSK. Ai, me këtë rast, tha: ,,zoti gjeneral, ju keni një staf shumë të përgatitur dhe profesional. Ne kur kemi filluar bashkëpunimin në këtë fushë, kemi bërë dy vizita në vit, dhe këto vizita kanë ndikuar shumë në ngritjen e sigurisë dhe hapat që janë zhvilluar kryesisht kanë qenë në fushën e trajnimit, përdorimin e harduerëve, softuerëve dhe sistemeve tjera të rëndësisë së veçantë që kanë të bëjnë me mbrojtjen kibernetike. Nënkoloneli Yazzie premtoi vazhdimin e realizimit të projekteve specifike, që kanë të bëjnë me këtë fushë, "ne do vazhdojmë edhe në të ardhmen me realizimin e vizitave dhe punëtorive të tilla, sipas planifikimit të përbashkët për ngritjen e kapaciteteve dhe përdorimin e tyre në mënyrë sa më efikase".

FSK-ja mori pjesë në aksionin për shënimin e "Ditës së Tokës"



Forca e Sigurisë së Kosovës(FSK), me personel dhe pajisje xheniere, me rastin e shënimit të "Ditës së Tokës", më 23 prill 2018, mbështeti aksionin vullnetar "Ta pastrojmë Kosovën", aksion ky i organizuar nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës. Për të përkrahur aksionin ishte edhe zëvendës komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Xhevahir Geci, si dhe pjesëtarë të FSK-së, së bashku me zyrtarë të organizatave dhe shoqërisë civile, pjesëtarë të Policisë së Kosovës, përfaqësues të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK (NALT), nxënës si dhe qytetarë u angazhuan tërë ditën në pastrim dhe mbjellje të drunjtëve dekorativ dhe lule në Komunën e Kastriotit.

Në këtë aktivitet, bazuar në planin e veprimit të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak (DBCU) dhe në koordinim të aktiviteteve me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, drejtues të Kuvendeve Komunale dhe Organizatave qeveritare dhe joqeveritare, nxënës, student dhe qytetarë të vullnetit të mirë, më 22-23 prill 2018, kanë realizuar aksionin në të gjithë Kosovën të koduar "Ta pastrojmë Kosovën".
FSK-ja ka mbështetur aktivitetin në qytetin e Suharekës, Rahovecit, mbi Hoqë të Madhe, në fshatin Plemetin të komunës së Kastriotit.

Në BRSH është mbajtur trajnimi „Taktikat me Njësi të Vogla"



Kompania 3A e Batalionit të 3-të dhe Kompania 2A e Batalionit të 2-të të BRSH-së, në kuadër të realizimit të planit vjetor, më 4 prill 2018, kanë përfunduar trajnimin "Gjenerimi i forcës", i cili është zhvilluar nga data 09.01 deri më 29.03.2018. Ky trajnim është përmbyllur me ushtrimin fushor "Ujku 2018'.'Dy ushtrimet ishin një aktivitet stërvitor i përbashkët në mes të FSK-së, KK-Skenderaj, KK-Istog, Policisë së Kosovës, qendrave emergjente, agjencive lokale qeveritare dhe joqeveritare të sigurisë të cilat operojnë në komunën e Skenderajt dhe atë të Istogut.
Qëllimi i këtyre ushtrimeve ishte rritja e ndërveprueshmërisë së FSK-së me institucionet tjera të cilat veprojnë në zonat e përgjegjësisë së Batalionit të Tretë dhe të Batalionit të Dytë të BRSH-së.

Në ushtrime ishin të angazhuara edhe njësitet e specializuara të Kërkim-Shpëtimit dhe të MKAB të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së. Ushtrimi fushor "UJKU 2018" u përcoll nga komandanti i BRSH-së, stafi i tij dhe KOMBAT-3, zv. Komandanti i MNBGW-së, n/kolonel Gregor HAFNER dhe stafi i tij, Policia e Kosovës, drejtori i zjarrfikësve dhe përfaqësuesit nga Skenderaj dhe Istogu.

Komandanti i BRSH-së, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj duke iu drejtuar pjesëtarëve të dy kompanive: 3A dhe 2A, i përgëzoi ata për profesionalizmin, gatishmërinë dhe motivimin e treguar gjatë realizimit të këtij ushtrimi dhe njëherësh kërkoi prej tyre të vazhdojnë me përkushtim në përmbushjen e obligimeve dhe kryerjen e detyrave të BRSH-së.

Gjeneral Hadërgjonaj gjithashtu falënderoi edhe Policinë e Kosovës dhe agjencitë civile të Skenderajt dhe Istogut për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre që treguan gjatë ushtrimeve.
Ndërsa, zv. komandanti i MNBGW-së n/kolonel Gregor HAFNER u shpreh i kënaqur nga ajo që pa, dhe gjithashtu i përgëzoi pjesëtarët për profesionalizmin dhe standardin e nivelit të lartë duke theksuar se të njëjtën gjë do ta kishte kërkuar edhe nga vartësit e tij.

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj

FSK-ja zhvilloi ushtrimin fushor „Skënderbeu-2018”

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së, në Ferizaj, më 13 prill 2018, u mbajt ushtrimi fushor “Skënderbeu-2018”.

Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë 433 pjesëtarë nga të gjitha njësitë e FSK-së. Pjesë e këtij ushtrimi janë pjesëtarët të cilët kanë qenë në trajnim në kurse të ndryshme në KDS, si pjesë e planifikimit, vëzhgimit, kontrollit dhe vlerësimit të Ushtrimit Fushor. Kurset e realizuara në 3 mujorin e parë janë: Procedurat Shtabore Komanduese; Kursi i Avancuar i Liderit; Kursi i Liderit Luftarak; Kursi Bazë i Nënoficerit; Kursi i Logjistikës; Kursi i Inxhinierisë; Kursi Reaguesit e Parë në Fushëbetejë; Kursi Transport Mirëmbajtje; Kursi i Komunikimit. Seria e kurseve ka përfunduar me ushtrimin fushorë të planifikuar nga KDS-ja të koduar me emrin ,,Skënderbeu 2018” . Kurset kanë qenë pjesë e planit të stërvitjes për tremujorin e parë 2018. Kanë filluar në kohë të ndryshme, por kanë përfunduar në të njëjtën datë duke organizuar Ushtrim fushor të përbashkët, prej datës 10-13.04.2018. Për të përcjell nga afër ushtrimin fushor ishin të pranishëm: komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu si dhe komandantët e batalioneve të njësive të FSK-së.



Komandanti i KDS-së, gjeneral Spahiu, me këtë rast, tha: “me mundësitë dhe kapacitetet tona, ne kemi përgatitur dhe kemi prezantuar të gjitha aktivitetet. E dimë se ka ende hapësirë për përmirësime që ne të jemi edhe më të përgatitur në të ardhmen”.

Ndërsa, gjenerali Enver Cikaqi vlerësoi lartë ushtrimin fushor. „Ky ushtrim është unik dhe përbën koncept të ri në historinë e Komandës dhe Stërvitjes. Ju keni pas fat që të jeni të parët në këtë koncept të ri. Ju përgëzoj të gjithëve ju siguroj se Komanda madhore do të jetë në mbështetje të KDS-së, për realizimin e stërvitjeve dhe përmbushjen e objektivave”.

UF ka pasur një strukturë në nivel Batalioni dhe është vlerësuar lartë në të gjitha fazat e realizimit të tij, duke përfshirë, planifikimin, përgatitjen, ekzekutimin dhe vlerësimin.

Prezantimin e brifingut të shkurtër e bëri kapiteni Alban Bujupi, në Qendrën Operative, ndërsa kapiteni Fanol Kola, bëri Brifingun e Forcës në Detyrë. Pjesëmarrësit përcollën disa nga inskenimet e planifikuara për ditën e vizitorëve.

Pjesëtarë të FSK-së në gjysmë-maratonën ndërkombëtare të atletikës në Prishtinë



Të dielën, më 29 prill 2018, në Prishtinë, është mbajtur gjysmë-maratona ndërkombëtare në atletikë, në të cilën morën pjesë atletë nga vendi ynë, dhe nga shumë shtete të botës. Në këtë garë; morën pjesë edhe 60 pjesëtarë të FSK-së, ku 44 prej tyre vrapuan në shtegun prej 21 km, ndërsa 16 pjesëtarë të tjerë, me uniformë ushtarake, vrapuan në shtegun prej 5 km. Të gjithë pjesëtarët e FSK-së, e kaluan shtegun me sukses, me ç’rast janë pajisur me certifikata dhe medalje nga organizatori.

Në përkujdesje të garuesve ishte i pranishëm edhe një ekip mjekësor i FSK-së, i gatshëm për t’iu dalë në ndihmë atletëve.

Orkestra e Forcave të Armatosura të Turqisë mbajti koncert në kazermën „Adem Jashari” në Prishtinë



Në Kazermën ,,Adem Jashari” në Prishtinë, më 25 prill 2018, Orkestra ,,Yjet e Harmonisë Turke” të Forcave të Armatosura të Turqisë, organizuar nga Kryesia e Këshillit Turk në Kosovë, mbajti koncertin e dytë në Kosovë.

Në fillim të programit u prezantua Orkestra ,,Yjet e Harmonisë Turke” të cilët shpalosën një program kulturo-artistik me këngë e muzikë të zgjedhur nga repertori i sajë, ku në mesin e këngëve zënë një vende edhe këngë të bukura Shqipe, si kënga: ,,Oj Kosovë oj nëna ime“, ,,Kënga e Poçarit” e shumë këngë të tjera të bukura që krijuan një atmosferë festive në sallën e amfiteatrit.

Në fund të programit komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjenerali Enver Cikaqi falënderoi Ushtrinë turke për bashkëpunim dhe orkestrën e FSK-së dhe atë Turke. Orkestra turke, komandantit të Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqit u dha dhuratë simbolike për bashkëpunimin dhe mundësinë e krijuar për të shfaqë këtë koncert. Në aktivitetin muzikor të Orkestrës ushtarake turke morën pjesë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të FSK-së, të cilët për një orë patën mundësi të shijojnë tingujt muzikor dhe këngët e artistëve ushtarak turk.

Në BRSH përfundoi trajnimi „Taktikat me Njësi të Vogla”

Në kazermën ,,Ushtarët e NATO-s’’ të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, më 10 prill 2018, u mbajt ceremonia e certifikimit të 28 pjesëtarëve të FSK-së, pas përfundimit të trajnimit ,,Taktikat me Njësi të Vogla- 01-2018’, gjenerata e parë për vitin 2018.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: Zv. komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Xhevahir Geci, komandanti i BRSH-së, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, shefi i Shtabit të BRSH-së, nënkolonel Ejup Maqedonci dhe komandantët e tri batalioneve të Reagimit të Shpejtë.

Gjenerali Xhevahir Geci vlerësoi lartë punën dhe angazhimin, si të instruktorëve po ashtu edhe të kursantëve dhe premtoi përkrahjen e vazhdueshme profesionale dhe morale nga ana e tij. Ndërsa, komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hadërgjonaj, me ketë rast, përgëzoi stafin e instruktorëve për disiplinën, përkushtimin dhe nivelin e lartë të profesionalizmit, duke shtuar se ky trajnim e rritë nivelin e aftësive profesionale dhe atë psiko-fizike të pjesëtarëve për të manovruar e vepruar nën stres dhe në situata të ndërlikuara në fushëbetejë. Ai theksoi më tej, se nga vizita e tij personale dhe nga raportimet e instruktorëve konstaton se kursantët kanë dëshmuar përkushtim dhe angazhim serioz gjatë trajnimeve. Disiplina dhe gatishmëria e pjesëtarëve në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve me saktësi dhe në nivel të lartë profesional, është ajo që atë dhe stafin e Brigadës e bënë më së shumti krenarë.



Togeri Taulant Gashi, shef i trajnimit u shpreh se gjatë periudhës 4 javore, ku pjesa më e madhe e trajnimit u realizua në terren malor dhe urban dhe nën kushte të vështira të motit, pjesëtarët e FSK-së, gjatë realizimit të trajnimit u sfiduan në shumë disiplina dhe treguan si paraqitje të lartë ashtu edhe lidership.

Trajnimi ,,Taktikat për Njësi të Vogla” ka filluar më 12 mars 2018 dhe ka zgjatur deri më 6 prill 2018. Kjo është gjenerata e parë për vitin 2018 dhe e 14-të me radhë. Këto janë planifikuar dhe realizuar nga instruktorët e Brigadës për Reagim të Shpejtë.

Në fund, për të gjithë pjesëtarët të cilët me sukses kanë përfunduar këtë trajnim u ndanë certifikata dhe mirënjohje për më të dalluarit.

FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 69 • 10 Qershor 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

FSK-ja përfundoi me sukses ushtrimin fushor ndërkombëtar “Shqiponja 6”

Udhëheqës shtetërorë dhe ushtarakë të Kosovës dhe të shteteve partnere më 11.05.2018, vizituan operacionet përfundimtare të ushtrimit fushor ndërkombëtar “Shqiponja 6”, në Kastriot, Batllavë dhe Koliq. Fillimisht në mjediset e ministrisë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti gjeneralët dhe oficerët e shteteve partnere dhe drejtuesit e agjencive të Kosovës, të cilët i falënderoi për bashkëpunimin, koordinimin dhe ndërveprueshmërinë gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor “Shqiponja 6”, ushtrim ky, i pari i këtij lloji, i planifikuar dhe ekzekutuar nga FSK-ja në bashkëpunim me agjencitë vendore dhe ushtritë partnere nga shtete të ndryshme.

Drejtori i ushtrimit fushor “Shqiponja 6”, gjeneral brigade Naim Haziri, për udhëheqësit shtetërorë dhe ushtarakë shpjegoi konceptin, objektivat, skenarin e ushtrimit më të madh vjetor të FSK-së, urdhrin operacional, javën akademike, pritjen dhe atashimin e kontingjenteve të shteteve mike në njësitë e FSK-së, dislokimin e njësive, ngritjen e kampit, funksionalizimin e komandës së përparme, atë të planifikimit si dhe me aktivitetet të tjera të ushtrimit ndërkombëtar “Shqiponja 6”.

Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ambasadori i SHBA-ve, Greg Delawie, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majori Timothy Orr, zv. ministri i Mbrojtjes të Maqedonisë, Bekim Maksuti, zv. ministri i FSK-së Agim Çeku, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK(NALT), gjeneral brigade Ralf Hofman, atasheu amerikan në Kosovë, koloneli Jeffry Fischer, gjeneralë të FSK-së, eprorë të lartë të Policisë së Kosovës, drejtues të agjencive të Kosovës për emergjenca, ushtarakë të shteteve mike pjesëmarrës në ushtrim fushor, fillimisht vizituan vend-incidentin e parë në Korporatën Energjetike të Kosovës në “Kosova A”, ku ishin simuluar skenarë të reagimit emergjent, pastaj vizituan lokacionin në Batllavë, tek penda ku dyshohej, sipas skenarit, për mjete eksplozive si dhe materie të rrezikshme të vendosura nga grupe kriminale.

Te Penda e Batllaves, aty



ku u demonstruan operacionet përfundimtare, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zoti Rrustem Berisha, tha: “Me këtë ushtrim, FSK-ja po dëshmon se ka avancuar me sukses si dhe ka dëshmuar fuqishëm se është Forcë e ndërveprueshme me ushtritë e vendeve partnere dhe se është e gatshme që të kontribuojë në garantimin e një ambienti të sigurt si në vend ashtu edhe në rajon e më gjerë”.



Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama e vlerësoi lart zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të ushtrimit, duke shprehur admirimin për një bashkëpunim dhe koordinim të të gjithë aktorëve në ushtrim, e sidomos ndërveprueshmërinë gjatë realizimit dhe ekzekutimit të skenarëve të ushtrimit. Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, tha se suksesi i ushtrimit është edhe një dëshmi se FSK-ja është e gatshme të marrë detyra të reja.

Nga ana e tij, ambasadori i SHBA-ve, Greg Delawie deklaroi se: “Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë krenare që kanë punuar përkrah Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe së bashku edhe me gjashtë shtete tjera, për të organizuar këtë ushtrim”. Më tej, ambasadori Delawie tha: “Gjithsej 88 ushtarakë amerikanë janë të përfshirë në ekzekutimin e ushtrimit “Shqiponja 6”, gjatë dy javëve të shkuara. Jam tepër krenar me punët e përmbushura nga ushtarakët tanë dhe partnerët ndërkombëtarë”.

Më pas, udhëheqësit ushtarakë vizituan edhe Komandën e përparme të ushtrimit në Koliq, ku u priten nga komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj. Ndërsa, për ecurinë e ushtrimit fushor ndërkombëtar “Shqiponja 6” i njoftoi komandanti i forcës në detyrë, nënkolonel Sylejman Cakaj, njëherësh edhe komandant i Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë.

Në fund, pjesëmarrësit e rreshtuar në ushtrim, i falënderuan komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majori Timothy Orr.

Në ushtrimin fushor ndërkombëtar “Shqiponja 6”, me njësi ushtarake morën pjesë: Garda Kombëtare e Ajovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kontingjente nga Kroacia, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Maqedonia dhe Republika e Shqipërisë, të cilat u atashuan në njësitë e FSK-së, pastaj Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Kryqi i Kuq i Kosovës.

Në ushtrimin fushor ndërkombëtar “Shqiponja 6’’ gjatë dy javëve sa zgjati ushtrimi morën pjesë gjithsej 1167 ushtarakë me mbi 147 automjete.

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën zëvendësshefin e Politikave dhe Planeve të Komandës së Bashkuar për Evropë të Ushtrisë së SHBA-ve

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 11.05.2018, kanë pritur në mjediset e ministrisë zëvendësshefin e Politikave dhe Planeve të Komandës së Bashkuar për Evropë të Ushtrisë së SHBA-së, gjeneral brigade Michael Turello, i cili shoqërohej nga një delegacion i gjerë ushtarakësh.

Gjenerali Michael Turello është ngarkuar, nga komandanti i Komandës së Bashkuar për Evropë i Ushtrisë së SHBA-së, që të marrë pjesë në ushtrimin fushor "Shqiponja-6".



Ministri Berisha ka falënderuar gjen eralin Turello për bashkëpunimin dhe ndihmën që SHBA ka dhënë dhe po jep për Kosovën dhe në veçanti për FSK-në. Ai me këtë rast e ka informuar gjeneralin Turello me të arriturat e FSK-së; duke nënvizuar faktin se FSK-ja për vitin e pestë me radhë nga publiku vendor është vlerësuar si institucioni më i besueshëm i sigurisë; shkallën e integrimit të komuniteteve pakicë, i cili aktualisht është mbi 10%; integrimin e suksesshëm të komunitetit serb; përfaqësimin e mirë të gjinisë femërore, e cila është mbi 8%, duke përmendur edhe faktin se nga marsi i këtij viti kemi femrën e parë që bartë gradën e gjeneralit.

Ministri Berisha ka folur edhe për nivelin e mirë të bashkëpunimit me shtetet fqinje dhe të rajonit, angazhimin në Kartën e Adriatikut A-5, ku Kosova dhe FSK-ja pretendojnë të kenë statusin e pjesëmarrësit me të drejta të plota. "Kur bashkëpunimi është i mirë dhe i gjerë në mes të shteteve të rajonit edhe situatat emergjente mund të përballohen më lehtë.

Nga ana e tij, gjenerali Turello ka përgëzuar ministrin Berisha dhe FSK-në për arritjet e deri- tashme. Ai ka premtuar se bashkëpunimi dhe ndihma nga Ushtria e SHBA-së do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke e vlerësuar pjesëmarrjen e Kosovës në mekanizmat rajonalë të sigurisë si një çështje vitale për sukseset e rajonit.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama qëndroi për vizitë zyrtare në SHBA



Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, i shoqëruar nga ambasadorja e Republikës së Kosovës Vlora Çitaku, atasheu i Mbrojtjes në SHBA kolonel Ilir Qeriqi, atasheu i Mbrojtjes së SHBA-ve në Prishtinë koloneli Jeffrey H. Fisher si dhe nga komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralmajor Timothy Orr, më 17 maj 2018 mori pjesë në ceremoninë e 25-vjetorit të Programit të Partneritetit Shtetëror (SPP) të Gardës Kombëtare të SHBA-ve, ku u prit nga gjeneral Joseph L. Lengyel, Komandant i Byrosë së Gardës Kombëtare në Kolegjin Kombëtar të Luftës, Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare Ft McNair, Washington DC. Gjeneral Rama e falënderoi Gjeneralin Lengyel për partneritetin e jashtëzakonshëm. Ai theksoi vizitën e fundit në Kosovë të mbi 100 qytetarëve të Ajovës nga sektorë të shumtë si: arsimi, bujqësia, biznesi i vogël, sporti, ushtria, siguria. Në veçanti e falënderoi për kontributin e zhvillimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 6".

Në kuadër të kësaj vizite, gjeneral Rama u takua me zyrtarët të lartë të Departamenti të Shtetit, Mr. Matt Palmer dhe me ndihmës asistenten e Sekretarit të Mbrojtjes Ms. Laura Copper me të cilët diskutoi mbi zhvillimet e fundit në FSK, sfidat e sigurisë ne rajon dhe procesin e tranzicionit të FSK-së në FAK. Gjeneral Rama i njoftoi me të arriturat e deritashme të FSK-së si një forcë e besueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe i falënderoi për mbështetjen e deritashme. Gjeneral Rama po ashtu pati takim në Senat, ku u takua me Senatoren Joni Ernst nga Ajova. Me këtë rast biseduan lidhur me zgjerimin dhe dinamizmin e Partneritetit Ndërshtetëror. Gjithashtu Gjeneral Rama u takua me kongresmenin Mike Turner nga Komitetit për NATO, me të cilin pati mundësi diskutimi lidhur me hapat dhe proceset e mundshme për integrim në strukturat e sigurisë rajonale dhe euroatlantike, si dhe e njoftoi për bashkëpunimin e FSK-së me NATO-n. Gjeneral Rama pati rastin dhe nderin të takonte të ftuarën e nderit për këtë mbrëmje, zonjën Dr. Heather Wilson, më ç 'rast theksoi vlerën e partneritetit dhe aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të mbështetur në orientime perëndimore dhe euroatlantike që ka Kosova.


Gjeneral Rama me sekretaren e Forcave Ajrore biseduan edhe mbi mundësinë për të përmirësuar sigurinë kibernetike në Kosovë, përmes mbështetjes së Forcave Ajrore, si zonë kryesore e misionit të Forcave Ajrore të SHBA-së. Në mënyrë të veçantë ai e falënderoi atë për mundësinë e përfshirjes së Kosovës për të konkurruar për herë të parë, për një vend (kadetë) në Akademinë e Forcave Ajrore të SHBA-ve në vitin 2019.

Gjeneral Rama pati mundësinë të vizitonte edhe Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare, ku për herë të parë, duke filluar nga gushti i këtij viti, një pjesëtar i FSK-së dhe një anëtar i PK-së, do të marrin pjesë në këtë universitet. Ky bashkëpunim do të mundësojë zhvillimin profesional të mekanizmave të sigurisë në vend. Po ashtu ai ka pasur edhe një vizitë të shkurtër në Akademinë e Trajnimit të Shërbimit të Emergjencave të Uashingtonit. Komandanti i FSK-së gjatë qëndrimit në SHBA u intervistua nga Zëri i Amerikës, mediat e Gardës Kombëtare dhe nga gazetarja e NBC.

Ministri Berisha priti ambasadorin e Francës Didier Chabert

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha priti më 21.05.2018, priti në takim, një delegacion të lartë të shtetit francez në krye me ambasadorin zotëri Didier Chabert. Me këtë rast, ministri Berisha falënderoi ambasadorin Chabert për mbështetjen dhe përkrahjen që shteti i Francës ka ofruar për Kosovën në shumë fusha si: politikë, siguri, etj., duke filluar që nga kontributi i Francës në kuadër të KFOR-it, kontributi në administratë e në fusha tjera. Ministri Berisha gjithashtu e njoftoi diplomatin francez mbi zhvillimet në sektorin e sigurisë në Kosovë, integrimin e komunitetit joshumicë, si dhe për planet për të ardhmen. Ministri Berisha në veçanti çmoi lartë angazhimin e Francës në intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, me akreditimin për herë të parë të atasheut të Mbrojtjes për Kosovë, si dhe angazhimin e vazhdueshëm për avancimin e marrëdhënieve në këtë fushë.

Nga ana e tij, ambasadori i Francës në Kosovë, zotëri Didier Chabert e përgëzoi ministrin për të arriturat dhe për kultivimin e një bashkëpunimi të vazh-



dueshëm ndërmjet dy vendeve. Ambasadori e njoftoj ministrin Berisha me emërimin e atasheut të Mbrojtjes dhe akreditimin e tij për Kosovë, kolonel Fabrice Duda, si dhe paralajmëroi intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë. Ambasadori Chabert gjithashtu paralajmëroi vizitën zyrtare në MFSK të Sekretares së shtetit pranë Ministrisë së Armatave në Qeverinë e Francës që do të zhvillohet së shpejti, vizitë kjo që pason vizitën e ministrit Berisha në Francë në vitin e kaluar. Ministri Berisha si dhe ambasadori Chabert shprehën gatishmërinë e dy vendeve tona për një bashkëpunim dhe intensifikim të tij në fushën e sigurisë në të ardhmen, që për Republikën e Kosovës është jashtëzakonisht me interes duke ditur rolin e Francës në Evropë si në Bashkim Evropian dhe në NATO.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjenerallejtënant Rrahman Rama merr pjesë në Konferencën e Shefave të Mbrojtjes në Gjermani

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në takimin vjetor të shefave të mbrojtjes në Wiesbaden të Gjermanisë. Në këtë konferencë morën pjesë shefat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s dhe shteteve partnere. Konferenca vjetore e shefave të mbrojtjes, e cila u organizua nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, kishte për tematikë luftën kundër organizatave ekstremiste të dhunshme.



Në njërën prej seancave të konferencës ka folur edhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i cili u fokusua në qasjen gjithëpërfshirëse të Kosovës në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, progresin e saj në parandalimin e këtij fenomeni si dhe vendosjen e një baze ligjore të aplikueshme që rregullon çështjen e pjesëmarrjes së shtetasve të Kosovës në luftërat e huaja.

Gjeneral Rama gjatë qëndrimit në Wiesbaden u takua edhe me gjeneralin Curtis M. Scaparrotti, të cilin e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme dhe përmbajtësore të cilën Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë po e jep për mbështetjen për Republikën e Kosovës, rajonin e Ballkanit në përgjithësi e veçanërisht në ngritjen profesionale të FSK-së.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama në këtë konferencë pati mundësi të takonte shefa të mbrojtjes me ç 'rast diskutuan mbi kompleksitetin dhe sfidat e sigurisë në regjion, si dhe shkëmbyen pikëpamje mbi kontributin dhe angazhimin e secilit për krijimin dhe ruajtjen e një ambienti të qetë dhe të sigurt.

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralin Timothy Orr





Ministri i FSK-së zoti Rrustem Berisha, më 9.05.2018, priti komandantin e Gardës Kombëtare (GK) të Ajovës gjeneralmajorin Timothy Orr, të shoqëruar nga një delegacion i gjerë civil dhe ushtarak nga Ajova dhe nga koloneli Jeffrey Fisher, atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-së në Prishtinë.

Ministri Berisha me këtë rast vlerësoi lart shkallën e bashkëpunimit të gjerë dhe intensiv në kuadër të partneritetit ekzistues në mes MFSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, duke theksuar se sukseset e arritura të FSK-së janë edhe meritë e kësaj garde dhe personalisht të gjeneralit Orr. Ministri Berisha theksoi edhe faktin se FSK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besuar i sigurisë në vend dhe me një trend rritjeje edhe te qytetarët serbë. Po ashtu prezantoi prezantuar rezultatet e FSK-së për integrimin e komuniteteve pakicë, në veçanti të komunitetit serb. Ai foli edhe për përfaqësimin gjinorë në FSK, duke nënvizuar se, që nga marsi i këtij viti, FSK-ja për herë të parë ka një femër me gradën e gjeneralit.

Në këtë takim, ministri vlerësoi lart pjesëmarrjen e pjesëtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës në ushtrimin fushor "Shqiponja -6", duke çmuar kontributin e tyre të vlefshëm si në fazën e përgatitjes së ushtrimit, po ashtu edhe në atë të ekzekutimit dhe sidomos shkallën e lartë të ndërveprueshmërisë së tyre me pjesëtarët e FSK-së.

Nga ana e tij, komandanti i Gradës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Timothy Orr, është shprehur se në Kosovë ndihet si në shtëpinë e tij. Ai ka përgëzuar ministrin për rezultatet e deritashme, sidomos ka vlerësuar lart integrimin e komunitetit serb në FSK, dhe rritjen e besueshmërisë në veri të vendit. Ai po ashtu ka falënderuar ministrin Berisha, për mundësinë e pjesëmarrjes në ushtrimin fushor "Shqiponja-6"të pjesëtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës, që përveç kontributit dhe rëndësisë së rritjes së ndjenjës së bashkëpunimit është edhe një përvojë e re për ata, koordinimi me partnerët në situata emergjente.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr, zhvilloi një takim edhe me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramën, ku së bashku biseduan për zhvillimet në FSK-së, përgatitjen e planeve për transformim dhe sfidat aktuale që po has ky proces.

Ndërsa, komandanti i FSK-së gjeneral Rama e njoftoi gjeneralin Orr, për rrjedhat e ushtrimit fushor "Shqiponja 6", duke theksuar se " ushtrimi po zhvillohet mirë dhe për FSK-në është sukses që për herë të parë kemi një numër kaq të madh të shteteve pjesëmarrëse". Temë bisede ishte edhe integrimi i suksesshëm i komuniteteve në FSK. "Tani kemi një tregim suksesi edhe me integrimin e komunitetit serb nga veriu i Kosovës, fakt ky që na bënë të ndihemi mirë". Ai po ashtu e ka njoftuar gjeneralin Orr edhe me rezultate e konferencë "FSK dhe Partnerët" duke i thënë se ishte mjaft e suksesshme dhe me numër një numër të madh të shteteve pjesëmarrëse.

Gjenerali Orr, në fund të takimit u shpreh se " ju si ministri dhe FSK-ja, keni bërë gjërat e duhura dhe në kohën e duhur. Ky është shtegu i suksesit që FSK-ja duhet ta ndjekë edhe në të ardhmen".

Gjenerali Enver Cikaqi vizitoi ushtrimin fushor "Comabined Resolve X", në Gjermani

Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Enver Cikaqi, më 8 maj 2018, ka vizituar operacionet e ushtrimit "Comabined Resolve X", ku po marrin pjesë edhe 15 pjesëtarë të FSK-së, në Ditën e Vizitorëve të Shquar, krahas personaliteteve tjera ndërkombëtare, në Gjermani. Gjeneral Cikaqi, nga drejtuesit e ushtrimit, mori komente dhe vlerësime shumë të larta për angazhimin, disiplinën dhe profesionalizmin që po tregojnë pjesëtarët e FSK-së, të cilët gjatë zhvillimit të këtij ushtrimi kanë pasur mundësi të punojnë dhe operojnë krah për krah me kolegët e tyre nga ushtritë ndërkombëtare, duke përfituar nga shkëmbimi i përvojave se si duhet punuar dhe vepruar në një mjedis shumëkombësh.

Gjatë kësaj vizite, komandanti i Forcave Tokësore, gjenerali Enver Cikaqi, pati takime të shumta me përfaqësues të ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s, me të cilët diskutoi për krijimin e mundësive rreth shkëmbimit të përvojave në kuadër të bashkëpunimit dypalësh rajonal.

Ushtrimi "Combined Resolve X" po realizohet nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR)



në Bazën e Ushtrisë Amerikane në Grafenëehr të Gjermanisë. FSK-ja në këtë ushtrim po merr pjesë me një kontingjent prej 15 pjesëtarësh. Fokusi dhe objektivi i këtij ushtrimi është ndërveprimi operacional i të gjithë pjesëmarrësve nga ushtria e NATO-s dhe aleatë tjerë, për të kuptuar dhe krijuar procedura operuese të përbashkëta. Ky është ushtrim shumëkombësh i operacioneve të unifikuara tokësore (Multi Unifeied Land Operation), i drejtuar nga Shtabi i Departamentit të Ushtrisë së SHBA-ve, për të stërvitur forcën e caktuar rajonale të SHBA-ve, të nivelit të brigadës, në mbështetje të objektivave të Komandës Evropiane të SHBA-ve (EUCOM), për bashkëpunim dhe siguri, ndërtimin e gatishmërisë me aleatët dhe partnerët e NATO-s.

„Shqiponja 6”, test për kapacitet rea



Ushtrimi fushor “Shqiponja 6” e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka mbledhur tetë shtete të cilat do ta zhvillojnë këtë ushtrim për të testuar kapacitetet mbrojtëse në situata emergjente dhe komplekse të sigurisë. Ky ushtrim do të zhvillohet në gjashtë komuna të Kosovës, në Prishtinë, Obiliq, Mitrovicë, Podujevë, Gjilan dhe Novobërdë.

Drejtori i ushtrimit fushor “Shqiponja 6” gjeneral brigade, Naim Haziri, tha se ky ushtrim ka qenë i planifikuar që nga shkurti i vitit 2017, dhe ka për qëllim testimin e kapaciteteve reaguese të pjesëmarrëseve në ushtrim.

“Qëllimi i këtij ushtrimi është që të realizohet një ushtrim fushor në nivel të FSK-së me pjesëmarrje të partnerëve, qofshin ata vendorë apo ndërkombëtarë, që të vlerësohen kapacitetet reaguese në situata komplekse, emergjente dhe të sigurisë. Situata e cila është dizajnuar është bërë në funksion të asaj që të gjitha agjencive pjesëmarrëse në këtë ushtrim t’iu mundësohet që t’i testojnë kapacitetet e veta reaguese në kuadër të misionit të vet kushtetues që e kanë në Kosovë dhe mbështetjes së partnerëve në mbështetje të trupave tanë në terren”, tha Haziri.

Haziri theksoi se shtetet pjesëmarrëse në këtë ushtrim do t’i testojnë standardet operative të përbashkëta. “Jemi pjesëmarrës tetë shtete në këtë ushtrim fushor që do t’i testojmë standardet operative të përbashkëta me partnerët dhe ndërveprueshmërinë tonë. Qëllimi kryesor i kësaj është që kurdoherë, në situata reale që paraqiten, ne të jemi të gatshëm të ndërveprojmë dhe të reagojmë në situata reale që ndodhin, duke i menaxhuar sa më mirë që është e mundur, në të mirën e qytetarëve, qoftë të Kosovës, qoftë të vendeve partnere”, shtoi Haziri.



Shpend Tërdeva nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës e quajti rast të mirë këtë ushtrim për demonstrimin e aftësive. „Ky ushtrim është një rast i mirë për demonstrimin e aftësive

Ministri Berisha dhe komandanti Rama në vendkomandën e ushtrimit fushor „Shqiponja 6”



Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, vizituan vendkomandën e ushtrimit fushor ndërkombëtar, në fshatin Koliq të Prishtinës, ku janë të dislokuar pjesëtarët e FSK-së së bashku më pjesëtarët e ushtrive partnere për të realizuar ushtrimin fushor „Shqiponja 6“, të parin ushtrim me karakter ndërkombëtar. Në Komandën e Përparme Operacionale, të vendosur në fshatin Koliq, ku ishin të përfaqësuara të gjitha njësitë e ushtrimit fushor ndërkombëtar „Shqiponja 6“, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj njoftoi për audiencën kryesore të ushtrimit si dhe njësitë pjesëmarrëse.

Gjatë vizitës, ministri Berisha dhe gjeneral Rama, u njoftuan nga drejtori i ushtrimit fushor, gjeneral brigade Naim Haziri, me qëllimin, objektivat, skenarin e ushtrimit fushor dhe me aktivitetet që janë paraparë të zhvillohen së bashku me ushtritë e vendeve partnere, Policinë e Kosovës, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave si dhe Kryqin e Kuq të Kosovës. Ndërkaq, komandanti në detyrë i ushtrimit, nënkoloneli Sylejman Cakaj, para ministrit dhe komandantit të FSK-së, paraqiti një ekspoze të aktiviteteve dhe operacioneve të zhvilluara që nga dita e dislokimit e deri më sot, si dhe i njoftoi ata, me bashkërendimin e veprimeve dhe ndërveprueshmërinë e FSK-së, me institucionet vendore dhe partnerët gjatë këtyre ditëve që po zhvillohet ushtrimi.

Me këtë rast, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha përgëzoi stafin planifikues dhe menaxhues të ushtrimit duke shprehur besimin e plotë se skenari i ushtrimit do të realizohet në tërësi dhe se ushtrimi do t’i arrijë objektivat e veta trajnuese.

Nga ana a tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e vlerësoi si mjaft të rëndësishme pjesëmarrjen e ushtrive partnere në ushtrim, atë të KFOR-it, si dhe agjencive vendore; duke theksuar se është me rëndësi komunikimi dhe ndërveprueshmëria ndërmjet institucioneve, në mënyrë që ushtrimi ndërkombëtar të arrijë objektivat e veta, ashtu siç është planifikuar.

Në Komandën e Përparme Operacionale, qëndruan sot edhe gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, të vendeve partnere, atashe të akreditуar si dhe zyrtarë të lartë të Presidencës dhe agjencive të sigurisë. Për herë të parë pjesë e këtij ushtrimi, me njësitë dhe përfaqësuesit e tyre, janë edhe shtetet si: Shqipëria, Garda e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë (SHBA), Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, KFOR-i dhe përfaqësuesit e Agjencive të Sigurisë dhe Emergjencave të Kosovës; Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe Kryqi i Kuq i Kosovës. Ushtrimi fushor i FSK-së “Shqiponja 6” përveç ushtrimeve të parapara në territorin e fshatit Koliq, është duke i vazhduar aktivitetet edhe në territorin e komunës së Prishtinës, Obiliqit, Podujevës, Novobërdës dhe Gjilanit. Ushtrimi fushor „Shqiponja 6” ka filluar zbatimin e skenarit-praktik në terren, më 4 maj dhe do ta përmbyll ushtrimin më 11 maj 2018.

guese të FSK-së në situata komplekse



profesionale në nivel vendi dhe atij ndërkombëtarë për të gjithë pjesëmarrësit. Po ashtu është një rast i mirë ku forcat e sigurisë pjesëmarrëse të njihen mes veti, të zhvillohen mbi bazat e sigurisë rajonale dhe përfundimisht do të jetë një rast i jashtëzakonshëm për ngritjen e kapaciteteve të përbashkëta në raste të nevojave operacionale",- theksoi Tërdeva.

Pjesë e ushtrimi fushor "Shqiponja 6" do të jetë edhe ushtria amerikane. Kolonel Justin Wagner tha se ky është një vit i veçantë dhe historik për këtë ushtrim, pasi që është hera e parë që Forca e Sigurisë së Kosovës ka organizuar një ushtrim të kësaj madhësie me skuadrat e specialiteteve ushtarake nga tetë vende të ndryshme. "Si partnerë ndërkombëtarë, ne jemi të nderuar që luajmë një rol, ndihmojmë dhe zhvillojmë, ekzekutojmë dhe vlerësojmë stërvitjen e këtij viti. Pjesëmarrja në këtë stërvitje është një mundësi e jashtëzakonshme për ne si partnerë ndërkombëtarë për të trajnuar forcat tona dhe për të kombinuar mjedisin, diçka që ne nuk kemi gjithmonë mundësi për të bërë, sidomos me fokusin në përgjigjen ndaj katastrofave



Ky ushtrim është në kohë të duhur dhe i përshtatet mirë aftësisë aktuale të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kjo u lejon atyre (FSK-së)të demonstrojnë aftësinë për t'i ardhur në ndihmë të gjithë popullit të Kosovës në kohë katastrofash natyrore ose atyre të shkaktuara nga njeriu",- tha Wagner.

Koloneli Wagner u shpreh i impresionuar me planifikimin dhe vëmendjen ndaj detajeve, të cilat anëtarët e FSK-së i kanë afruar këtij ushtrimi. Sipas tij, ky është një testim për fokusin që ata kanë vënë në ndërtimin e kapaciteteve në mandatin e tyre aktual dhe zhvillimin e aftësisë së lartë për KFOR-in dhe partnerët rajonalë. Ushtrimi fushor "Shqiponja 6" do të zgjasë nga sot deri më 11 maj 2018.

Komandanti i FSK-së ndanë certifikata mirënjohje për pjesëmarrësit e ushtrimit fushor „Shqiponja 6"





Në MFSK, më 12 maj 2018, me aktorët pjesëmarrës, u mbajt takimi vlerësues për zhvillimet e ushtrimit fushor "Shqiponja-6". Në takim ishin të pranishëm komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFT-së, gjeneral major Enver Cikaqi, gjeneral majori Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Naim Haziri, oficerë dhe nënoficerë nga ushtritë e shteteve pjesëmarrëse, FSK-ja dhe agjencitë emergjente. Takimin e kryesoi drejtori i ushtrimit, gjeneral brigade Naim Haziri, i cili konstatoi se, ushtrimi fushor ka qenë shumë i suksesshëm, i ka arritur objektivat e planifikuar dhe është zhvilluar i tëri sipas planit dhe pa ndonjë lëndim apo incident të pjesëmarrëseve.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij me rastin e përfundimit të ushtrimit fushor "Shqiponja-6", vlerësoi lart pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shteteve pjesëmarrëse, duke i falënderuar dhe duke ju shprehur mirënjohje për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre profesional. "Niveli i arritur në këtë ushtrim ishte një shkallë e re e organizimit dhe përvojë e re për ne, rezultati i së cilës na inkurajon që në të ardhmen të kemi edhe më shumë shtete pjesëmarrëse. Në këtë mënyrë ne rrisim bashkëpunimin dhe njohjet si dhe besimin mes pjesëtarëve të ushtrive mike dhe aleate. Na gëzon fakti që kemi arritur këtë sukses, por kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për më mirë. Ky ushtrim e ka arritur qëllimin e paracaktuar, ka qenë ushtrim i madh dhe i rëndësishëm për FSK-në dhe Kosovën. Ka qenë ushtrim historik. Është e rëndësishme të jemi të ndërveprueshëm me institucionet vendore, por kur jemi të ndërveprueshëm me partnerët ndërkombëtarë, atëherë kjo tregon se FSK-ja është e gatshme për detyra të reja dhe misione ndërkombëtare. Urojmë që të ju kemi serish në Kosovë, edhe në ushtrimet tjera. Do të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen, sepse ne dëshirojmë të jemi pjesë e juaja, të jemi anëtarë në NATO-s".

Me pastaj, komandanti i FSK-së, ndau certifikata mirënjohjeje për përfaqësuesit e njësive të shteteve pjesëmarrëse dhe për individët e dalluar të cilët kontribuuan në mbarëvajtjen e ushtrimit fushor "Shqiponja-6".

Ministri Berisha në manifestimin për "Ditën e Çlirimit" në Shqiponjë të Dushkajës

Në manifestimin për nderë të 17 Majit "Ditën e Çlirimit" dhe "Ditën e Dëshmorëve" të Shqiponjës së Dushkajës të Komunës së Gjakovës, në emër të Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha bëri homazhe para obeliskut të dëshmorëve si dhe mbajti një fjalë rasti në emër të parit të Qeverisë. Me këtë rast, ministri Rrustem Berisha çmoi lartë rolin e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave të Shqiponjës së Dushkajës, të Komunës së Gjakovës, për kontributin në filet e organizimit të luftës së UÇK-së, konsolidimit e deri në përfundim të luftës, çlirimin e rajonit të Dushkajës dhe të vetë Shqiponjës, vendlindjes së shumë heronjve të UÇK-së, si dhe bazë e sigurt e strehimit dhe rrugë e furnizimit për shumë zona të luftës.



Në vazhdim, ministri Berisha, tha: "Jam shumë i nderuar, që sot në Shqiponjë, si ministër i FSK-së mund të ju drejtohem, në këtë ditë të shënuar, jo vetëm për shqiponjën, por edhe për trevën e Dushkajës, Gjakovës dhe tërë Kosovës. Këtë nderim e shpreh edhe në emër të kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj". "Sa herë përmendet Shqiponja, në mbamëndjen tonë dhe të historisë, na vije kujtesa për pushkët e para të lirisë, pastaj shndërrimin e këtij territori në zonë të pakalueshme për forcat serbe në atë kohë, pikërisht nga dëshmorët e lirisë dhe heronjtë e Kosovës që i nderojmë sot, po edhe shumë luftëtarë të gjallë të këtyre trevave që malet e Dushkajës dhe Sukën e Cermjanit e bënë fortifikatë pararojë të Jabllanicës së atëhershme ndaj forcave të shumta serbe të asaj kohe...". Më tej, ministri Berisha, në manifestimin e 17 Majit "Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të fshatit Shqiponjë" bëri një ndërlidhje të sakrificës së popullit tonë në luftën për çlirim si dhe aktualitetit, ku populli i Kosovës dhe shteti ynë është duke ndërtuar institucione të qëndrueshme të cilat garantojnë paqe dhe prosperitet për shtetin tonë dhe gjithë qytetarët e saj. Në Shqiponjë ishte i pranishëm edhe kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës Kadri Veseli, kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, deputeti Daut Haradinaj, gjeneralët e FSK-së: Xhevahir Geci dhe Fadil Hadergjonaj, si dhe përfaqësues të shoqatave dhe institucioneve të vendit si dhe qytetarë të shumtë.

Kadetët e Kosovës në shënimin e Ditës së Personelit Ushtarak të Forcave të Armatosura të Turqisë

Në Akademinë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë në Ankara, më 8.05.2018, është shënuar Dita e Personelit Ushtarak Mysafir (MAP Günü). Në mesin e kadetëve nga 20 shtete të ndryshme të botës, Republikën e Kosovës e prezantuan 9 kadetë të Kosovës, që studiojnë në Akademinë Ushtarake në Turqi. Të pranishëm ishin edhe kadetët që janë duke vijuar mësimet në Fakultetin e Mjekësisë Ushtarake (GATA). Me rastin e shënimit të kësaj dite, aktivitetet e kadetëve të FSK-së, u zhvilluan nën organizimin dhe përkujdesjen e atasheut ushtarak të FSK-së, në Ankara, nënkolonelit Bekim Osmani. Kadetët tanë, atje, prezantuan me dinjitet shtetin e Kosovës, FSK-në, kulturën dhe traditën e vendit tonë. Në këtë ditë, i gjithë personeli i huaj kishte për detyrë që të përfaqësojë vendin e vet me ushqime, veshje kombëtare, uniformën ushtarake, fotografi me bukuritë natyrore, broshura të ndryshme rreth organizimit dhe aktiviteteve ushtarake, etj. Përveç komandantit të Akademisë i cili njëherësh ishte edhe nikoqir, për ta përcjellë këtë ngjarje kishin ardhur edhe shumë gjeneralë dhe oficerë tjerë të lartë vendorë si dhe atashe nga vende të ndryshme të botës. Gjatë vizitës së tyre tek këndi i Kosovës, nga atasheu ynë, ata u njoftuan me atë që kishin



përgatitur për përfaqësim duke jua përshkruar në pika të shkurtra historinë dhe bukuritë natyrore të Kosovës. Kadetët tanë, në mënyrë të shkëlqyer kishin përgatitur këndin e përfaqësimit dhe këndin e ushqimeve, të cilat nuk kaluan pa fjalë miradije nga komandanti i Akademisë Ushtarake dhe të gjithë të pranishmit tjerë. Sidomos u krijua një atmosferë mjaft e mirë gjatë ekzekutimit të valles shqiptare nga kadetët tanë dhe ata të Shqipërisë, e cila bëri që të ndizet atmosfera, duke u bërë kështu pjesë e saj pothuajse edhe të gjithë kadetët e vendeve të tjera. Edhe këtë vit, kjo paraqitje u realizua me përkrahjen e FSK-së, Ambasadës së Republikës së Kosovës në Ankara, dhe familjeve të stafit të ambasadës.

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral Spahiu priti komandantin e KFOR-it, gjeneralin Salvatore Cuoci



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcë së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneral brigade Irfete Spahiu, priti në vizitë komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Salvatore Cuoci. Gjatë kësaj vizite, për komandantin e KFOR-it, u prezantua struktura, misioni i KDS-së dhe planet për të ardhmen. Gjithashtu, komandanti i KFOR-it, pati rastin të vizitojë dhe të shohë nga afër disa nga mjediset ku zhvillohen trajnimet në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe po ashtu të njihet me trajnimet të cilat ofrohen në këtë qendër për pjesëtarët e FSK-së.

Gjatë takimit të përbashkët, gjeneral Cuoci e përgëzoi komandantin e KDS-së, gjeneral Spahiun, për ngritjen e saj në detyrë, si dhe shprehu gatishmërinë e tij, për mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së dhe në veçanti të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hadërgjonaj priti drejtorin e NALT-it, gjeneralin Ralf Hoffmann

Në ambientet e kazermës "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, në Istog, komandanti i saj, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj me bashkëpunëtorë, priti më 18 maj 2018, në një takim zyrtar, drejtorin e NALT-it, Ekipit Ndërlidhës dhe Këshillues të NATO-s për FSK-në, gjeneral brigade Ralf Hoffman. Komandanti i BRSH-së, gjeneral Hadërgjonaj, me këtë rast e njoftoi drejtorin e NALT-it me zhvillimet e përgjithshme në BRSH dhe njësitë e saj, si dhe me strukturën, misionin, detyrat, aktivitetet dhe të arriturat e



BRSH-së, me fokus në arsimimin dhe stërvitjen e personelit, infrastrukturën dhe pajisjet. Në ambientet e kazermës "Ushtarët e NATO-s", ata vizituan disa nga objektet e brigadës si: poligonet, pajisjet, armatimin, automjetet dhe u informuan për aktivitetet e Brigadës së Reagimit të Shpejtë dhe Batalionit të Dytë. Gjenerali Hoffmann shprehu respektin dhe përshtypjet e tij shumë pozitive kundrejt BRSH-së, në përgjithësi dhe për ushtrimin fushor "SHQIPONJA 6" në veçanti, duke theksuar se kishte vizituar dhe ndjekur nga afër organizimin dhe operimin e Forcës në Detyrë në Bazën e Përparme Operacionale, si dhe përmes vëzhguesve dhe kontrolluesve të NALT-it në nivele të ndryshme. Po ashtu, ai vlerësoi lart standardet e instalaara në BRSH dhe nivelin e lartë të zbatimit të tyre si në aspektin e disiplinës, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe automjeteve, ashtu edhe infrastrukturës akomoduese dhe asaj përcjellëse. Në fund të vizitës drejtori i NALT-it, gjenerali Hoffmann, uroi gjeneralin Fadil Hadërgjonaj dhe stafin e tij për punën dhe profesionalizmin duke ofruar mbështetjen e tij, si dhe siguroi që të ofrojë ekspertizë përmes këshilltarëve të NALT-it, në të gjitha nivelet ku kërkohet.

Përurohet rruga në Budisalc të Klinës

Forca e Sigurisë së Kosovës në vazhdimësi është duke ndihmuar popullatën e Kosovës me projekte, që po i realizon në bashkëpunim me organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Sot, është bërë përurimi rrugës në fshatin Budisalc i banuar kryesisht me popullatë të komunitetit serbë, ndërsa punët janë kryer nga Batalioni i Xhenios i Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me komunën e Klinës, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, organizatën IOM dhe mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar. Realizimi i projekteve të tilla ka për qëllim lehtësimin e jetës dhe qarkullimin më të lehtë të qytetarëve të Kosovës, ndërsa realizimi i këtij projekti, do t'ju lehtësoj banorëve të fshatit qarkullimin dhe qasjen më të mirë në Manastirin e Budisalcit. Në përurimin e rrugës morën pjesë: komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Ruairi O'Conell, kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, drejtori i Drejtorisë për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në MFSK, Hajrush Kurtaj, përfaqësues të IOM-it, Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, përfaqësues të manastirit të fshatit Budisalc, banorë të fshatit, oficerë të KFOR-it dhe të FSK-së. Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj falënderoi ambasadorin e Britanisë, komandantin e FSK-së dhe FSK-në për angazhimin dhe kontributin e dhënë për mbështetjen në kryerjen e punimeve në këtë rrugë.
Ndërsa, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Ruairi O'Conell falënderoi FSK-në, për angazhimin dhe kryerjen e shërbimeve për të gjitha komunitetet. Ai tha se: ,,me FSK-në, kemi bashkëpunuar ngushtë në realizimin e këtij projekti". Kurse, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast theksoi se, ,,ne si FSK, për çdo ditë po e dëshmojmë se jemi forcë e besueshme për të gjithë qytetarët me punën dhe angazhimin tonë. Sa do, që është një projekt simbolik, ne po mundohemi të krijojmë kushte sa më të mira për lëvizjen e gjithë qytetarëve pa dallime etnie. Ne do të vazhdojmë të mbështesim dhe të japim kontributin tonë edhe në të ardhmen në të gjitha fushat me kapacitetet tona".



Komandanti i RMC-së, koloneli Shaip Haziri priti drejtorin e NALT-it gjeneralin Ralf Hoffmann

Drejtori i NALT-it, Ekipit Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, për MFSK/FSK-në, gjeneral brigade Ralf Hoffmann është pritur nga komandanti i Regjimentin e Mbrojtjes Civile (RMC), kolonel Shaip Haziri dhe stafi i Regjimentit. Vizita e gjeneralit Hoffmann në RMC ishte e fokusuar në aspektin e ndihmës profesionale dhe këshillimit që po japin këshilltarët e NALT-it për FSK-në. Ai u njoftua nga komandanti i RMC-së, kolonel Haziri, për misionin e Regjimentit dhe njësive nën vartësi për punën dhe aktivitetet të cilat zhvillohen në kuadër të Regjimentit të Mbrojtjes Civile. Gjenerali Hoffmann rëndësi të veçantë i ka dhënë edhe vizitës në Qendrën Trajnuese për Kërkim-Shpëtim, ku është takuar me stafin dhe instruktorët e kësaj qendre duke u njoftuar për misionin, aktivitetet e kaluara, ato në realizim e sipër dhe objektivin apo synimin për të ardhmen. Gjenerali Hoffman u nda i kënaqur me punën dhe i përgëzoi të gjithë për angazhim dhe theksoi se do të jetë në mbështetje të Regjimentit në ngritjen e kapaciteteve të tij, si dhe në mbështetje në trajnime e këshillime nga ekspertët e kësaj fushe.

Në Universitetin Amerikan diplomojnë 15 kadetë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së

Dje, (17.05.2018) në AUK u mbajt ceremonia e diplomimit të studentëve të këtij universiteti. Në ceremoninë e diplomimit mori pjesë edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, gjenerali amerikan Wesley Clark, kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, si dhe shumë mysafirë të ftuar.

Në këtë ceremoni, diplomuan edhe 15 kadetë të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, gjenerali amerikan në pension Wesley Clark, mbajti një ligjëratë për kadetët dhe stafin udhëheqës të Qendrës për Studime Universitare (QSU). Në këtë ligjërate ishin të pranishëm: Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irefete Spahiu dhe stafi i AUK-ut. Ushtruesi i detyrës së Komandantit të Qendrës së Studimeve Universitare, kapiteni Vegim Krelani mirëpriti dhe falënderoi gjeneralin Clark, për gatishmërinë e treguar për të ligjëruar para stafit dhe kadetëve të QSU-së.



Gjenerali amerikan Wesley Clark, me të marrë fjalën, deklaroi se është i impresionuar me të arriturat e FSK-së. Në ligjërimin e tij ai shpalosi përvojat dhe sfidat në karrierën e tij ushtarake. Rëndësi të veçantë i kushtoi përgatitjes profesionale dhe vendimmarrjes në të gjitha nivelet e udhëheqjes. Ai, më tutje elaboroi kornizën e udhëheqjes ushtarake përmes përshkrimit të atributeve se si një lider duhet të: ,,JETË, DIJË DHE BËJË ", duke u bazuar në përvojat e tij personale si ushtarak. Ligjërata u mirëprit dhe u cilësua si mjaft produktive dhe e rëndësishme nga audienca, posaçërisht nga kadetët tanë të cilët patën mundësinë që t`i parashtrojnë edhe pyetje të shumta. Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, në përfundim të ligjëratës, gjeneralit Wesley Clark i dha dhuratë simbolike, në shenjë mirënjohje dhe respekti për kontributin e tij të dhënë për çlirimin e Kosovës.

Në ceremoninë e 14-të të diplomimit të kadetëve të FSK-së, në Universitetin Amerikan në Kosovë, diplomuan 15 kadetë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së prej të cilëve 13 kadetë i takonin vitit të IV-të "Gjenerata 2018", ndërsa 2 kadetë të vitit III-të, "Gjenerata 2019" të cilën arritën që me sukses t'i përfundojnë provimet- një vit më herët. Kadeti Premtim Shaqiri "Gjenerata 2018" u dekorua me çmimin "Highest Honours" për arritje të larta akademike.

KEK-u i dhuron tri automjete të shkatërruara Qendrës së Trajnimit për Kërkim - Shpëtim

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) i dhuroi tri (3) automjete të shkatërruara Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së në Pomozotin. Ky donacion është ndihmuar nga Dr.sc. Adil Januzi, drejtor Ekzekutiv i Divizionit të Prodhimit të Qymyrit në KEK. Drejtori i QTKSH-së lidhur me këtë donacion është shprehur: "Unë nuk mund ta theksoj mjaftueshëm vlerën e këtij donacioni.

Ekipi im i trajnimit dhe unë, jemi gjithherë të angazhuar në kërkim të metodave të reja dhe kreative, për të ofruar përvoja



sa më të mira për studentët tanë. Për disa njerëz, këto automjete mund të konsiderohen si mbeturina, por për ne këto automjete edhe pse të shkatërruara janë mjaft të rëndësishme, sepse na hapin mundësinë për të zhvilluar skenarë dhe përvoja të reja për studentët tanë, të cilët janë duke u trajnuar në kërkim-shpëtim urban, malor dhe ujëra.

Në këto skenarë përfshihen edhe katastrofat natyrore si: tërmetet, shembjet e dheut, vërshimet si dhe shkatërrimet nga vet njerëzit, siç janë: demolomi i ndërtesave, aksidentet industriale dhe shumë incidente të tjera. KEK-u gjithherë ka qenë mbështetje e fortë e FSK-së edhe para se të hapej QTKSH. Konkretisht, në shtator të vitit 2016, KEK-u na ka ofruar ndihmë inxhinierike dhe ekspertizë për lëvizjen e tre vagonëve të trenit, të dhuruar nga Trainkos, nga Fushë Kosova për në Pomozatin.

Kjo detyrë përfshinte një ekip të punonjësve të KEK-ut, të cilët kishin punuar gjatë tërë vikendit deri në mbrëmjet e vona". Qendra e Trajnimit për Kërkim–Shpëtim, çdo ditë e më tepër po zhvillohet dhe ngritët duke u bërë kështu pikë kyçe e ushtrimeve, jo vetëm për FSK-në por edhe për organizata tjera partnere siç është KFOR-i.

Në Brigadën për Reagim të Shpejtë u mbajt gara „Ujku Garues-2018"



Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, më 25.05.2018, u mbajt ceremonia e shpalljes së rezultateve të garës "Ujku Garues 2018".

Ky është viti i katërt më radhë, që BRSH-ja organizon këtë garë, në të cilën, pjesëmarrësit marrin pjesë si ekip dhe garojnë si një trupë e përbashkët. Këtë vit, kanë marrë pjesë gjithsej 13 ekipe, me nga pesë pjesëtarë nga Batalioni i Parë, i Dytë dhe i Tretë i BRSH-së, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, QSU, KFOR-i Amerikan, Danez dhe Polak.

Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë edhe komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, komandanti i KDS-së gjeneral brigade Irfete Spahiu, shefi i Shtabit të BRSH-së nënkolonel Ejup Maqedonci, komandantë të batalioneve, oficerë dhe nënoficerë të BRSH-së dhe të njësive tjera të FSK-së.

Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, falënderoi pjesëmarrësit në emër të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramës dhe përgëzoi Brigadën e Reagimit të Shpejtë për organizimin e shkëlqyer, si dhe ekipet e ushtrisë amerikane, daneze dhe polake.

Ndër të tjera, gjeneral Cikaqi, tha, se gara: "Ujku Garues-2018" është aktivitet i cili tregon ndërveprueshmërinë dhe aftësinë operuese të ekipeve pjesëmarrëse, por njëkohësisht me pjesëmarrjen e ekipeve të KFOR-it, pasqyrohet ndërveprueshmëria institucionale e FSK-së me aktorët tjerë të sigurisë në Kosovë, në këtë rast me KFOR-in.

"Unë si komandant i Forcave Tokësore dhe zv. komandant i FSK-së, jam tepër krenar që pjesëtarët tanë çdo ditë janë krah për krah me partnerët tanë në trajnime dhe në gara të ndryshme. Uroj që së shpejti të marrin pjesë edhe në misione të ndryshme. Pjesëtarët tanë gjatë garave të ndryshme kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme dhe shumë suksese në trajnime të ndryshme. Po dëshmojmë se ne jemi të gatshëm, për të marr detyra të reja në mbrojte të vendit dhe të sigurisë",- tha në fund komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral Cikaqi.

Ndërsa, komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hadërgjonaj tha se "Qëllimi i mbajtjes së garave është që të testohen shkathtësitë ushtarake në disa disiplina, ta ngremë nivelin e aftësive psikofizike dhe profesionale të ekipeve tona, me theks të veçantë ta ngremë nivelin e punës ekipore dhe ta avancojmë shpirtin garues me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe ndërkombëtare. Rezultatet që janë arritur ndër vite tregojnë se pjesëtarët tanë gjithmonë kanë shfaqur aftësi të larta fizike dhe profesionale. Dua të theksoj vetëm disa nga garat e këtij viti, të karakterit gjithëpërfshirës dhe ndërkombëtar, siç ishte gara e ushtarit më të mirë në nivel të FSK-së, me pjesëmarrje ndërkombëtare, pastaj gara e ushtarit më të mirë në Kroaci dhe së fundmi kjo garë ekipore që u përmbyll sot. Rezultatet e arritura tregojnë për nivelin e lartë të përgatitjes fizike dhe profesionale të ushtarëve tonë në përgjithësi dhe në veçanti të pjesëtarëve të BRSH-së", tha gjeneral Hadërgjonaj.





Gjeneral Hadërgjonaj përgëzoi edhe ekipin e NOF të BRSH-së, instruktorët dhe ekipet vlerësuese për organizimin dhe realizimin e suksesshëm të garës, kurse ekipet garuese dhe ato të KFOR-it i falënderoi për pjesëmarrjen dhe i uroi për rezultatet e treguara. Në fund të garës, në bazë të paraqitjes së treguar në të gjitha disiplinat e kësaj gare u përzgjodhën tri ekipet më të mira. Vendin e parë e zuri ekipi i dytë i Brigadës për Reagim të Shpejtë, vendin e dytë ekipi i parë i Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe vendin e tretë ekipi i KFOR-it polak.

Për të gjitha ekipet pjesëmarrëse në garë, KOMBRSH ndau certifikata dhe mirënjohje.

FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 70 • 10 Korrik 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

Në Prishtinë zbulohet pllaka përkujtimore në nderim të ushtarëve të NATO-s

Me një ceremoni shtetërore, nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, më11.06.2018, në qendër të kryeqytetit të Kosovës në Prishtinë, u bë zbulimi i pllakës përkujtimore në nderim të ushtarëve të NATO-s dhe KFOR-it të rënë në Kosovë që nga 12 qershori 1999. Në këtë aktivitet të pranishëm ishin: Kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendës asistenti i sekretarit të NATO-s, John Manza, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Cuoci, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Ralf Hoffmann, ambasadori i SHBA-ve, Greg Delavie, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Ruairi O'Conell, ish-komandantët e KFOR-t, gjeneralët Buhler, De Marnak, etj., ambasadorë të shteteve të akredituar në Kosovë, ministra, deputetë e mysafirë të tjerë.

Me këtë rast, ministri Berisha tha: ,,U bënë 19 vite nga koha kur NATO udhëhoqi operacionin për mbështetjen e paqes në Kosovë, operacion ky që ktheu shpresën për liri dhe siguri. 12 qershori i vitit 1999 do të mbetet përjetësisht në historinë më të re të Kosovës, si dita e kthimit të shpresës kur e përjetuam lirinë dhe çlirimin. Që nga ajo ditë Bota dhe miqtë tanë liridashës na ofruan bindjen që ne nuk jemi vetëm në holokaustin që po përjetonim. Me mijëra ushtarë dhe paqeruajtës na ndihmuan të ndalohej gjenocidi ndaj popullit shqiptar dhe bashkërisht të ndërtonim një Kosovë të re, si shtet i pavarur dhe sovran me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj. Monumenti që ndërtuam në kujtim të 15 ushtarëve të rënë që nga viti 1999 e deri më sot është shumë pak për të falënderuar ata që bënë aq shumë për ne, por është gur i garancisë



dhe miqësisë së përjetshme ndërmjet Kosovës dhe popujve paqeruajtës në Ushtrinë e NATO-s dhe djemve tanë më të mirë që kontribuuan në rrugëtimin drejt lirisë sonë. Në cilësinë e Ministrit të FSK-së, falënderoj nga zemra familjarët e ushtarëve të rënë në krye të detyrës në territorin e Republikës së Kosovës, duke i siguruar ata se do të mbeten përjetësisht pjesa e jona e çmuar drejt paqes dhe prosperitetit. Falënderojmë NATO-n, KFOR-in dhe shtetet mbështetëse për kontributin e dhënë për një mjedis të qetë e të sigurt, për mbështetjen e vazhdueshme që po japin në zhvillimin e FSK-së. Së bashku Kosova dhe NATO-ja kanë të arritura të shumta dhe me të drejtë mund të krenohemi me arritjet tona të përbashkëta. Memoriali që po zbulojmë sot do të mbetet jo vetëm si testament për ata që kanë bërë sakrificën përfundimtare, por edhe për angazhimin tonë të përbashkët në interes të ndërtimit të paqes dhe stabilitetit". Në fund, ministri Berisha falënderoi të gjithë ata që kontribuuan në iniciativën dhe në ndërtimin e këtij obelisku, duke u shprehur: "Kemi nderin dhe respektin që përjetësisht ta ruajmë kujtimin për paqeruajtësit tanë, ata që e dhanë jetën për ta ruajtur jetën". Pas fjalëve përshëndetëse të kryeministrit Haradinaj, komandantit të KFOR-it, gjeneral Cuocci-t dhe zëvendës asistentit të sekretarit të NATO-s, John Manza, u bë zbulimi i pllakës përkujtimore të ushtarëve të KFOR-it dhe NATO-s të rënë në Kosovë. Në Obeliskun me stemë të NATO-s dhe KFOR-it, në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, shkruan: ,,Në kujtim të burrave dhe grave që kanë shërbyer me partnerët e tyre në KFOR dhe kanë dhënë jetën si rezultat i shërbimit të tyre. Ne nderojmë dhe përkujtojmë sakrificën e tyre."

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha priti në vizitë ministren e Mbrojtjes së Francës, znj. Genevieve Darrieussecq



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Rrustem Berisha, më 01.06.2018, priti në një vizitë zyrtare me ceremoni ushtarake ministren e Mbrojtjes së Francës, znj. Genevieve Darrieussecq. Ministri Berisha së bashku me ministren e Francës, znj. Darrieussecq kryesuan edhe takimin e përbashkët të dy delegacioneve, ku biseduan për bashkëpunimin e dyanshëm në mes të Kosovës dhe Francës, MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Francës si dhe për zhvillimet në fushën e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Fillimisht, ministri Berisha e falënderoi ministren Darrieussecq për bashkëpunimin dhe për ndihmën që Franca ka dhënë dhe po jep për Kosovën, dhe më pas e njoftoi me zhvillimet e përgjithshme në Ministri dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me theks të veçantë për integrimin e gjinisë femërore dhe të komunitetit joshumicë në FSK, si dhe për gatishmërinë e FSK-së që të kontribuoj për paqen dhe sigurinë kudo që ka nevojë, në mënyrë që Kosova të jetë kontribuuese e paqes dhe sigurisë.

Gjithashtu, ministri Berisha i shprehu ministres të Mbrojtjes së Francës, znj Darrieussecq, interesimin për akademitë dhe shkollat ushtarake franceze, me qëllim të shkollimit dhe trajnimit të oficerëve dhe ushtarëve tanë atje. Ai po ashtu shprehu dëshirën për arritjen e një memorandumi bashkëpunimi ndërmjet të dyja vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në të cilin do të konkretizoheshin aktivitetet e përbashkëta.

Ndërsa, ministrja e Francës, znj. Darrieussecq, pasi që shprehu falënderimin e saj për pritjen, e përgëzoi ministrin Berisha dhe komandantin e FSK-së gjeneral Ramën për të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Ajo nder të tjera tha, se "rajoni i Ballkanit vazhdon të jetë i rëndësishëm për Francën, dhe në vazhdimësi jemi krenarë që kemi kontribuar për vendin tuaj. Franca është e kënaqur me të arriturat e vendit tuaj për të ecur përpara. Bashkëpunimi ndërmjet nesh do të vazhdojë të intensifikohet në të ardhmen. Atasheu ushtarak i sapo akredituar për Kosovën do të jetë urë lidhëse ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Francës dhe Ministrisë së FSK-së". Në fund, të dy ministrat u zotuan për intensifikimin e bashkëpunimit dhe mundësinë e rritjes së këtij bashkëpunimi në të gjitha fushat me interes për të dyja vendet.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama merr pjesë në Konferencën Vjetore të Ushtrisë Amerikane për Evropë



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, nga data 19-21.06.2018, po merr pjesë në Konferencën Vjetore të organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë, që po mbahet në Garmish të Gjermanisë.

Qëllimi i mbajtjes së kësaj konference është thellimi i bashkëpunimit në Programin e Partneritetit Ndërshtetëror. Bashkëpunimi në mes të Kosovës përkatësisht FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës (Iowa), është modeli më i mirë që tregon se si në një periudhë të shkurtër mund të arrihet progres në të gjitha nivelet e zhvillimit profesional të një force.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama gjatë kësaj konference takoi shumë liderë dhe shefa të Mbrojtjes të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të vendeve Baltike dhe përfaqësues të EUCOM-it. Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneral majori Timothy Orr, në forumin e Ballkanit Perëndimor, diskutuan edhe lidhur me mundësitë dhe planet për të ardhmen në kuadër të zgjerimit dhe thellimit të aktiviteteve, përfshirë qasjen rajonale, ndërtimin e aftësive dhe trajnimet e përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit rajonal. Konferenca vjetore e organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë, pritet që sot t'i përfundojë punimet.

Ministri dhe komandanti i FSK-së priten në takime të ndara komandantin e operacioneve speciale të NATO-s

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën më 28.06.2018 në Ministri, komandantin e Operacioneve Speciale të NATO-s, nën-admiralin Colin Kilrain. Fillimisht, ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i Operacioneve Speciale të NATO-s biseduan mbi situatën e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë, si dhe u bisedua për kapacitetet institucionale të vendit në fushën e sigurisë, me theks të veçantë mbi zhvillimin, profesionalizimin, avancimin si dhe bashkëpunimet e FSK-së me shtetet anëtare dhe atyre partnere të NATO-s. Gjithashtu, ministri Berisha e njoftoi nën-admiralin Kilrain për misionin, detyrat, kapacitetet dhe angazhimin e Forcës për integrimin e komuniteteve, në veçanti të komunitetit serb, pastaj integrimin e gjinisë femërore dhe angazhimin në rritjen e shkallës së ndërveprueshmërisë me institucionet emergjente vendore ashtu edhe ato nga vende partnere. Më pas z. Berisha i shprehu mysafirit të lartë nga NATO-ja gatishmërinë operacionale dhe profesionale të FSK-së, që me disa kapacitete specilistike të marrë pjesë edhe në misione paqeruajtëse për të dhënë kontribut në ruajtjen e paqes kudo që ka nevojë. Ministri Berisha në fund të takimit me nënadmiralin Kilrain edhe një herë përsëriti orientimin euroatlantik të Kosovës dhe të FSK-së si Forcë e gatshme, e besueshme, shumetnike dhe e përfaqësuar nga të gjithë qytetarët e vendit. Ndërsa në takimin e Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama me komandantin e NATO-s për Operacione Speciale, nënadmiralin Colin Kilrain u bisedua për ngritjen, zhvillimin, profesionalizimin, shkollimet, trajnimet dhe pjesëmarrjen në ushtrime të përbashkëta qoftë në rajon e më gjerë, e gjithashtu edhe mbi të arriturat në ngritjen e shkallës së ndërveprueshmërisë së FSK-së me ushtritë e rajonit, ato të shteteve anëtare të NATO-s dhe vendeve partnere. Vizita e nënadmiralit Kilrain vazhdoi në Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së për të parë nga afër kapacitet profesionale dhe pajisjet e kësaj njësie.




Komandanti i FSK-së priti komandantin e Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate për Evropë



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me komandanten e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu, në kazermën ,,Skënderbeu'' në Ferizaj, më 28.06.2018, pritën në vizitë, komandantin Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate për Evropë në Napoli, Admiralin James Foogo i cili shoqërohej nga komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Cuoci.

Në takimin e përbashkët të gjeneral Ramës, gjeneral Spahiut dhe Admiralit Foggo u bisedua për misionin, detyrat dhe të arriturat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, zhvillimin dhe profesionalizimin, bashkëpunimet me institucionet tjera partnere si në rajon ashtu edhe me partnerët strategjik si dhe për objektivat për zhvillimin dhe avancimin e kësaj Force në të ardhmen si një institucion i të gjithë qytetarëve, në dobi dhe interes të vendit tonë dhe partner i besueshëm i shteteve mike të Kosovës. Gjenerali amerikan u njoftua gjithashtu edhe për misionin dhe detyrat e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si institucion i cili trajnon, shkollon dhe stërvit pjesëtarët e FSK-së për shërbim në detyra specifike në njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe zhvillon profesionalizmin e pjesëtarëve tanë të cilët në institucione shkollore, trajnuese dhe garuese ndërkombëtare po tregojnë rezultate të shkëlqyera. Për admiralin Foogo, në pjesën e dytë të vizitës u paraqit një material informues, ku u prezantua struktura, organizimin dhe të arriturat e KDS-së, me theks të veçantë stërvitjet në qendrat stërvitore dhe përgatitja e pjesëtarëve të FSK-së për të ardhmen e tyre profesionale.



Auditi i Përgjithshëm vlerësoi lart performancën e menaxhimit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në bazë të raportit të Auditimit të Përgjithshëm të Qeverisës së Kosovës, për vitin paraprak 2017, del se ,,prezanton një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik".

Për gjetjet e përgjithshme nga pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë për FSK-në, Auditori i Përgjithshëm është –Opinion i pamodifikuar- që nënkupton se:

,,Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore".

Më tej në raport konstatohet se: ,,Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin në MFSK në përgjithësi ka vendosur kontrolle të mira në raport me obligimet statutore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit. Aranzhimet e qeverisjes në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. MFSK ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), si dhe ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj" thuhet në raportin e Auditit të Përgjithshëm".

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe stafi i lartë drejtues ndihen krenarë me këto vlerësime të Auditit të Përgjithshëm, po ashtu jemi të vetëdijshëm se ka vend për më shumë dhe më mirë, sidomos duke u fokusuar në të ardhmen në përmirësimin e gjetjeve të cilat do ta ngritin edhe më lartë këtë performancë të Ministrisë për FSK-në.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Deputetët e Parlamentit të Gjermanisë vizituan Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, z. Rrustem Berisha priti më (21.06.2018) në ministri një delegacion të deputetëve të Parlamentit të Republikës Federale të Gjermanisë, anëtarë të Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, në krye me z. Wolfgang Hellmich. Në takimin e përbashkët të dy delegacioneve, të kryesuara nga z. Berisha dhe z. Hellmich, u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërshtetërore, Kosovë–Gjermani, në shumë fusha e me theks të veçantë në fushën e sigurisë. Në fillim, ministri Rrustem Berisha e falënderoi shtetin dhe popullin gjerman për mbështetjen e pakursyer që kanë dhënë dhe po japin për Kosovën, në ndërtimin, avancimin e institucioneve, me theks të veçantë në fushën e sigurisë si dhe profesionalizimin dhe avancimin e FSK-së. Ministri Berisha gjithashtu theksoi rolin mjaft të rëndësishëm të Gjermanisë në shkollimin, trajnimin dhe pajisjen e FSK-së, si dhe në përgjithësi rolin mjaft aktiv të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Gjermanisë si një partner strategjik dhe i fokusuar në situatën në Kosovë, që nga viti 1999 e deri më tani. Ministri Berisha i njoftoi deputetët gjermanë për misionin, detyrat, të arriturat, sfidat si dhe objektivat për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së në të ardhmen, duke përmendur trajnimet dhe shkollimet si brenda ashtu edhe jashtë vendit të pjesëtarëve të FSK-së, pjesëmarrjen në stërvitje të përbashkëta me partnerët tanë, integrimin e komuniteteve joshumicë dhe të gjinisë femërore, si dhe mbi objektivat e FSK-së për të ardhmen, për arritjen e së cilave rol të rëndësishëm padyshim luan edhe shteti i Gjermanisë. Gjithashtu edhe zv. ministri i MFSK-së, Burim Ramadani para deputetëve gjermanë prezantoi planet dhe objektivat për një Kosovë të sigurt si dhe shpalosi faktet dhe rrugën lidhur me përpjekjet politike për gjithëpërfshirje. Nga ana e tij, kryetari i Komitetit të Mbrojtjes pranë Bundestagut Gjerman, z. Wolfgang Hellmich tha se Gjermania do të mbështesë Kosovën edhe më tutje: „Ju mund të llogarisni në mbështetjen tonë edhe më tutje". U shpreh gjithashtu se do të angazhohen që të gjejnë edhe më shumë fusha konkrete bashkëpunimi, si dhe shprehu gatishmëri për thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Kjo ishte vizita e parë e Komitetit të Mbrojtjes të Parlamentit Federal të Gjermanisë, prej se ministri Berisha është emëruar në krye të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Gjenerali Gëzim Hazrolli qëndroi për vizitë zyrtare në Gjermani



Drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, gjeneral majori Gëzim Hazrolli, me ftesë zyrtare, nga 17-22.06.2018, ka qëndruar për vizitë në Forcat e Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë. Gjeneral Hazrolli është pritur nga gjeneral brigade Oliver Kohl, komandant i Akademisë së Udhëheqësve në Hamburg. Gjatë vizitës në Akademinë e Udhëheqësve u bisedua për përvojat, praktikat dhe programet arsimore dhe zhvillimore të këtij institucioni si dhe mundësitë për zgjerimin e fushave të bashkëpunimit në të ardhmen që do të ishin në interes të shkollimit të pjesëtarëve të FSK-së. Gjithashtu, gjeneral Hazrolli ka vizituar edhe Qendrën për Udhëheqje të Brendshme të Bundesverit në Koblenz, ku u prit nga drejtori i Qendrës, gjeneral majori Reinhardt Zudrop me të cilin biseduan për mundësitë dhe kapacitetet trajnuese që ofron kjo qendër për shkollimin dhe trajnimit e ushtarakëve por edhe për kapacitetet që ofron kjo Qendër për FSK-në dhe shkollimin e pjesëtarëve të saj. Nga të dy qendrat gjeneral Hazrolli mori mbështetje për gatishmërinë e vazhdimit të bashkëpunimit dhe përkrahjes së FSK-së drejt avancimit dhe ngritjes profesionale. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë kanë marrëdhënie shumë të mira bilaterale si dhe aktivitetet vjetore në kuadër të këtij bashkëpunimi janë të shumta.

Mbahet punëtoria „Ngritja e Kapaciteteve për Forcimin e Transparencës, Përgjegjshmërisë dhe Integritetit në Sektorin e Sigurisë"



Nën udhëheqjen e ekspertëve të NATO-s, Ministrisë së Mbrojtjes të Norvegjisë dhe atyre të KFOR-it, më 14 qershor 2018, u mbajt punëtoria e radhës „Ngritja e Kapaciteteve për Forcimin e Transparencës, Përgjegjshmërisë dhe Integritetit në Sektorin e Sigurisë." Punëtoria u mbajt në kuadër të rritjes së bashkëpunimit NATO-Kosovë. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin menaxherë të segmenteve dhe fushave nga institucionet e sigurisë në vend.

Në sesionin e parë të punimeve të kësaj punëtorie morën pjesë: ministri i FSK-së Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj dhe drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për MFSK/FSK, gjeneral brigade Ralf Hoffmann.

Ministri Berisha në fjalën e hapjes tha: "Është shumë inkurajues fakti që po shohim një pjesëmarrje kaq të gjerë dhe aktive dhe një interesim të lartë nga institucionet e Kosovës për temën e kësaj punëtorie. Udhëheqësit e FSK-së janë të vetëdijshëm se integriteti institucional publik është parakusht për një shoqëri funksionale. Rendësi të veçantë i kemi kushtuar ngritjes dhe forcimit të integritet në MFSK, e cila synon anëtarësimin në NATO. Ndërtimi i Integritetit dhe Qeverisja e Mirë në Sektorin e Sigurisë është interes i përbashkët në kornizën e ndërveprimit të avancuar NATO-Kosovë''.

Sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, në fjalën e tij, tha se Integriteti në MFSK/FSK tanimë është bërë vlerë dhe standard në institucionin tonë, vlerë kjo e krijuar në përkrahje të partnerëve tanë strategjikë dhe ndihmës së miqve tanë ndërkombëtarë, duke mos harruar asnjëherë angazhimin e palodhshëm të të gjithë personelit, si dhe mbështetjen pa rezervë të ministrit të MFSK-së, z. Berisha. Në fund, z. Sylaj edhe njëherë konfirmoi gatishmërinë e MFSK/FSK-së që të ofrojë për institucionet tjera vendore të gjitha kapacitetet profesionale në implementimin e Planit të Integritetit 2019-2022 si dhe ekspertizën tonë në hartimin e planeve të integritetit, në përkrahje të të gjitha institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ndërsa, drejtor i NALT-it, gjenerali Hoffmann vlerësoi lartë angazhimin e MFSK/FSK-së në avancimin e implementimit të Planit të Integritetit: "Kjo ngjarje po zhvillohet mbi suksesin e konferencës për ndërtimin e integritetit të mbajtur më 18 nëntor 2017 në Prishtinë, organizuar nga Ministria për FSK-në. Pjesëmarrja aktive dhe interesimi për këtë temë është inkurajim dhe ne duam të vazhdojmë bashkëpunimin tonë me institucionet e Kosovës në fushën e Qeverisjes së Mirë dhe Ndërtimit të Integritetit. Kjo temë është e rëndësishme për NATO-n".

Policia e FSK-së zuri vendin e tretë në garën për forcimin e ligjit

Në kampin e KFOR-it amerikan në Bondsteel (Ferizaj), dje më 20.06.2018 u mbajtën gara testuese të ekipeve të njësive të forcimit të ligjit në Kosovë dhe të vendeve partnere, për përgatitjen e tyre fizike dhe psikike si dhe detyra tjera policore. Të gjitha ekipet pjesëmarrëse gjatë testimeve/garave kanë kaluar nëpër këto disiplina: gjuajtje aktive, fitnes fizik, shkathtësi të ngasjes emergjente, gjuajtje nën presion me pistoletë 9mm, ndalesë të trafikut me rrezikshmëri të lartë, shkathtësi të angazhimit në vend-incident dhe neutralizimin e një personi. Në këtë garë morën pjesë gjashtë ekipe të forcimit të ligjit: Policia e Forcës së Sigurisë të Kosovës, Policia Ushtarake Ndërkombëtare e KFOR-it, Policia e Kosovës, Policia Kufitare e Kosovës, Policia Ushtarake Gjermane dhe Policia Ushtarake Amerikane. Ekipi i Policisë së Forcës të Sigurisë së Kosovës zuri vendin e tretë, duke u radhitur mbas Ekipit të Policisë Ushtarake Amerikane (vend i parë) dhe Policisë Ushtarake Ndërkombëtare nga KFOR-i (vend i dytë). Komandanti i Kampit Bondsteel, koloneli Nick Ducic, në fund, ekipeve fituese u dhuroi mirënjohje dhe medalje për suksesin e treguar gjatë kësaj gare.

Biza-Shqipëri

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama përcolli ushtrimin fushor të BRSH-së „Biza - 2018”




Batalioni i Parë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, nga 3 qershor deri më 12 qershor 2018, realizoi ushtrimin fushor të koduar,, Biza-2018” në poligonin ushtarak Biza të Republikës së Shqipërisë. Në këtë ushtrim morën pjesë mbi 350 ushtarë me 30 automjete.

Qëllimi i këtij ushtrimi është vlerësimi i performancës operuese të kompanive të Batalionit, në një situatë komplekse të sigurisë dhe emergjencës me qëllim të certifikimit të tyre për operacionet MAC dhe OMP, si dhe testimit të aftësisë së BN për zbarkim dhe vetë qëndrueshmëri të operacioneve. Për të përcjellë nga afër zhvillimet e ushtrimit fushor të Batalionit të Parë të BRSH-së, dje (12.06.2018) në Biza, qëndruan komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, kolonel Jeton Dreshaj, shef i Kabinetit të Komandantit të FSK-së, atasheu ushtarak i Kosovës në Republikën e Shqipërisë, koloneli Bashkim Shillova, komandanti i Batalionit të Parë të BRSH-së, majori Berat Shala dhe Jashar Ramadani shef i Kabinetit të Ministrit Rrustem Berisha.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama përgëzoi stafin udhëheqës dhe Batalionin e Parë, për realizimin e objektivave gjatë ushtrimit fushor “Biza 2018”, si dhe falënderoi ushtrinë shqiptare për përkrahjen dhe për mundësinë e realizimit të këtij ushtrimi.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama para të pranishmëve tha: „Ju përgëzoj për të gjitha të arriturat gjatë realizimit të ushtrimit fushor “Biza 2018”. Mendoj dhe besoj se qëllimi dhe synimi juaj është arritur me sukses. Gjithashtu e di se keni pasur vështirësi në përshtatje me një ambienti të tillë. Qëllimi kryesor i ushtrimit ka qenë sfidimi i vetvetes, vetë qëndrueshmëria dhe komandimi dhe kontrolli, dhe këtë e keni arritur. Pra, jeni një batalion model për të tjerët dhe të vazhdoni për të avancuar më tutje, në të ardhmen. Kërkoj që të jeni të ndërvepruesshëm edhe me partnerët tanë. Ky është misioni juaj, ketë e keni zgjedhur që nga faza e planifikimit dhe ekzekutimit. Megjithëse është arritur qëllimi, nuk duhet të jemi të vetëkënaqur, por duhet të jemi në hap me zhvillimet më të reja, pra në hap me kohën. Realizimi i këtij ushtrimi është një arritje e madhe e jona, dhe unë kërkoj nga ju që këto njohuri të reja me përgjegjësi të lartë t’i bartni te të tjerët”. Batalioni i Parë i BRSH-së, sot e përfundon ushtrimin fushor “Biza-2018”.



Komandanti i Operacioneve Speciale të NATO-s vizitoi Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së

Nënadmirali Colin Kilrain, komandanti i Operacioneve Speciale të NATO-s i shoqëruar nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama përcollën dje (29.06.2018) nga afër trajnimin ,,Niveli i parë për zhytje” të FSK-së, në liqenin e Batllavës. Për delegacionin e lartë një material prezantues rreth trajnimit e paraqiti drejtori i Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së, John Doone si dhe shefi i QRTKSH, kapiten Besnik Hasani, të cilët folën për rëndësinë e këtij trajnimi, që është realizuar në



tri lokacione, Pomozotin (pjesa teorike), Banjë të Malishevës dhe Batllavë (pjesa praktike e trajnimi). Shefi i instruktorëve, kapter Valdrin Kelmendi tregoi për ecurinë e trajnimit që realizohet me qëllim të ngritjes së numrit të zhytësve në kuadër të FSK-së. Në këtë trajnim intensiv, me pjesëmarrje nga të gjitha njësit e FSK-së. Vizita e nën-admiralit dhe gjeneral Ramës ka vazhduar edhe në ambientet e kazermës ,,Evropianët e rinj” në Pomozotin, ku është bashkuar edhe komandanti i Gardës Kombëtare të shtetit të Ajovës së SHBA-ve, gjeneral major Timothy Orr. Në Pomozotin ata u pritën nga komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile(RMC), kolonel Shaip Haziri si dhe të gjithë së bashku vizituan hapësirat, poligonet e trajnimit dhe objektet e kazermës, dhe në veçanti ato të Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, e cila mëton të funksionojë si Qendër Regjionale e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, në të cilën që nga viti i kaluar janë realizuar trajnime për Policinë e Kosovës, për pjesëtarët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë etj.

Në KDS certifikohen kursantët për instruktorë të taktikave

Në kazermën ,,Skënderbeu” të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, më 11.06.2018, u mbajt ceremonia e certifikimit të trajnimit ,,Kursi Ndërkombëtar për Instruktorë të Taktikave” në të cilin morën pjesë 39 pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së. Kursi ka qenë i mbyllur dhe ka zgjatur tri javë. Instruktorët ishin nga Ushtria e Mbretërisë së Bashkuar.

Në këtë ceremoni të pranishëm ishin komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar Ruari O’Conell, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë koloneli Sainthrope, si dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Në fjalën e tij, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar Ruari O’Conell, pos tjerash, tha: ,,FSK-ja dhe Ushtria e Mbretërisë së Bashkuar janë duke bashkëpunuar në mënyrë të shkëlqyeshme dhe se ky angazhim i madh është duke dhënë rezultate konkrete”. Ai gjithashtu shprehu gatishmërinë që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe në të ardhmen, duke u shprehur: , gjithë ky mund do të shfaqet në të ardhmen gjatë aktiviteteve të FSK-së”.

Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, me këtë rast i përgëzoi kursantët e FSK-së për rezultatet e arritura dhe për disiplinën e treguar në këtë trajnim, ndërsa instruktorët nga Mbretëria e Bashkuar i falënderoi për përkushtimin dhe punën që kanë bërë gjatë këtij trajnimi me pjesëtarët e FSK-së. Në fund të ceremonisë, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, kursantëve u dha certifikata, kurse instruktorëve mirënjohje për angazhimin profesional të tyre gjatë mbajtjes së trajnimit.



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj

Diplomoi gjenerata 2018 e kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës



Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ferizaj, më 25.06.2018 u zhvillua ceremonia e diplomimit të kadetëve ,,Gjenerata 2018" të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së. Pas diplomimit, me gradë nëntogeri u graduan gjithsej 11 oficerë të rinj të cilët me sukses mbaruan shkollimin katër vjeçar për udhëheqje në Qendrën për Studime Universitare dhe atë akademik në Universitetin Amerikan në Prishtinë. Në aktin e veçantë të diplomimit të kadetëve, morën pjesë: ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, zv. ministrat Burim Ramadani dhe Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës së (SHBA) gjeneral majori Timothy Orr, zv. komandanti i KFOR-it, gjeneral major Janos Csombock, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për FSK, gjeneral brigade Ralf Hoffman, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Irfete Spahiu si dhe gjeneralë e oficerë të FSK-së, KFOR-it, familjarë të kadetëve etj.

Pas pjesës ceremoniale, rreshtimit të kadetëve, intonimit të himnit shtetëror, fjalën e rastit e mbajti ministri Rrustem Berisha i cili me këtë rast tha: ,,Gjatë kësaj periudhe 4 vjeçare ju keni kaluar nëpër sfida të shumta të cilat falë punës, angazhimit dhe vendosmërisë ju keni përfunduar me sukses dhe nga sot po gradoheni me gradën e nëntogerit. Gradimi i juaj në oficer të FSK-së po bëhet në një fazë shumë të rëndësishme të zhvillimit të FSK-së, kur edhe pritet që kjo Forcë t'i avancoj kapacitetet operacionale dhe ta ndryshojë misionin e saj. Ky standard i arritur



është një shembull i qartë i zhvillimit dhe progresit që po e bënë FSK-ja me profesionalizëm dhe në arritje të standardeve më të larta ushtarake të NATO-s." Në fund të fjalës së tij, ministri Berisha iu drejtua kadetëve; ,,Të dashur kadet, nuk ka mision më të shenjtë se sa kontributi për vlerat e lirisë dhe sigurisë andaj ju dëshiroj suksese në këtë rrugëtim, po ashtu një falënderim i veçantë edhe për familjet e juaja të cilat ju kanë qëndruar dhe mbështetur në vazhdimësi".

Ndërsa, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, foli për detyrat, rolin dhe rëndësinë e oficerëve në institucionin tonë, me ç'rast tha: ,,Të jesh oficer është detyrë jo e lehtë, që përkon me shumë sfida dhe përgjegjësi. Dhe sa më lartë që shkoni në karrierë, privilegjet tuaja rriten por njëherë edhe përgjegjësitë dhe detyrat tuaja shumëfishohen. Jo më kot thuhet, që një lider duhet të jetë, të dijë dhe të bëjë. Të jetë me vlera ushtarake dhe atribute mentale, fizike e emocionale; të dijë aftësitë ndër-personale, konceptuale, teknike dhe taktike, si dhe të bëjë influencimin, drejtimin dhe përmirësimin e vartësve të vet". Ajo, në fund të fjalës së saj, pos tjerash, tha: ,, QSU-ja ishte dhe vazhdon të mbetet institucioni edukativo-arsimor kredibil ngase gjatë këtyre viteve, ajo ka dëshmuar gatishmërinë, përkushtimin dhe disiplinën për të përmbushur misionin e saj. Nga kjo qendër kanë dalë shumë oficerë të rinj, të cilët tashmë janë pjesë e çdo angazhimi dhe njësie të suksesshme, shkollimi i të cilëve është bërë sipas standardeve të NATO-s".

Diplomat për kadetët e sapo diplomuar i ndanë: ministri Berisha, gjenerali Orr, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneral brigade Irfete Spahiu dhe kapiteni Vegim Krelani. Kadeti Premtim Shaqiri u dekorua me ,,Medalje" për rezultate të larta në përvetësimin e programit akademik. Me gradën nëntoger u graduan: Klevis Elezaj, Bajram Geci, Defrim Kurti, Kreshnik Dreshaj, Valdrin Pollomi, Arlind Osmani, Meriton Haxholli, Erblin Çoçaj, Shkelqim Raci, Argjend Lokaj dhe Premtim Shaqiri. Nga sot FSK-së iu shtuan edhe 11 oficerë të rinj të cilët shërbimin do ta fillojnë me gradën nëntoger dhe se do të sistemohen në detyrat e punës, në të gjitha njësitë e FSK-së.

Komandanti i FSK-së, dekoroi me medalje „Shërbim vetëmohues" pjesëtarët e Kërkim-Shpëtimit të FSK-së



Në një ceremoni të organizuar në Regjimentin e Mbrojtjes Civile, më 05.06.2018, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama ka dekoruar me medaljen ,,Shërbim Vetëmohues" pjesëtarët e Task Forcës së Kërkim-Shpëtimit.

,,Unë ju përgëzoj për punën dhe angazhimin tuaj. E di dhe e kuptoj se në çfarë kushtesh ju veproni dhe çfarë rrezikshmërie keni në punën tuaj. Kam qenë vet i pranishëm gjatë kërkimit të dy policëve të aksidentuar në Kaçanik. Po ashtu kërkimi dhe gjetja e viktimës vikendin e kaluar tregon për punën dhe angazhimin serioz që ju jeni duke e bërë. Shpresoj që kurrë mos të kemi thirrje për angazhimin tuaj, se e di sa e vështirë është të gjesh dhe të tërheqësh një viktimë, por ju e keni treguar me punën tuaj se jeni të gatshëm dhe të përgatitur për çdo situatë" tha ndër të tjera në fjalën e tij, gjeneral Rama.

Në fund të ceremonisë të gjithë pjesëtarëve iu ndanë medalje për ,,Shërbim Vetëmohues."

Certifikohen pjesëmarrësit e trajnimit „Menaxhimi taktik i traumave"

Në kazermën ,,Adem Jashari" të FSK-së, më 08 qershor 2018, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 15 pjesëtarëve të FSK-së dhe Policisë së Kosovës, të cilët kryen trajnimin dyjavorë-cikli i tretë, me temë: ,,Menaxhimi taktik i traumave" (Ndihma e parë e avancuar). Trajnimi është mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve, përkatësisht Zyra për Mbështetje Civile-Ushtarake (CMSE) dhe është zhvilluar nga instruktorë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në ceremoninë e certifikimit, gjenerali Xhevahir Geci, në fjalën e tij, tha: ,,Ndihem i nderuar që sot jam pjesë e kësaj ceremonie përmbyllëse. Dua të përmend bashkëpunimin e shkëlqyer që ka FSK-ja me Policinë e Kosovës dhe Ambasadën Amerikane që është një tregues i qartë i progresit që kemi sot si FSK". Trajnimi është realizuar nga Kompania e Mjekësisë e FSK-së në koordinim me Zyrën Mbështetëse Civile–Ushtarake të Ambasadës së SHBA-së dhe ka për qëllim avancimin e FSK-së në ndërveprueshmëri me institucionet tjera.

Duke iu drejtuar kursantëve, gjeneral Geci, shtoi: ,,Të nderuar kursantë, kërkoj nga ju, që me njohuritë që i keni fituar të jeni përgatitur mjaftueshëm për të intervenuar në rastet reale kur do që kërkohet ndihma juaj. FSK-ja vlerëson lartë angazhimin e Ambasadës së SHBA-ve, andaj unë si zv. komandant i Forcave Tokësore falënderoj Ambasadën Amerikane për kontributin e vazhdueshëm që po jep në ngritjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së dhe institucionet tjera të sigurisë në Kosovë".

Me një fjalë u paraqit edhe drejtori i Policisë Kufitare për rajonin e Mitrovicës, nënkolonel Mentor Shabani i cili tha: ,,Në fazën e projekti të përbashkët në mes të FSK-së dhe Ambasadës Amerikane, ku pjesëtarët e Policisë po trajnohen në aspektin elementar të ndihmës së parë mjekësore, që është element i cili i ka munguar organizatës sonë".

Kurse përfaqësuesi i Ambasadës nga Zyra Ndërlidhëse Civilo-Ushtarake, kapiteni Justin Bauer falënderoi kursantët dhe të pranishmit, duke thënë: Gjatë këtyre dy javëve ju keni mësuar shumë shkathtësi të reja për të shpëtuar jetë. Unë shpresoj se ju kurrë nuk do të ndodheni në situata të tilla, por edhe nëse ndodheni unë jam i kënaqur që ju i keni fituar këto shkathtësi. Në fund u ndanë certifikatat për të gjithë pjesëtarët që përfunduan trajnimin dhe gjithashtu u certifikuan edhe dy pjesëtarë të FSK-së, të cilët kanë ndjekur kursin ,,Parandalimi i vetëvrasjeve" në kampin Bondsteel.

FSK-ja nderon me medalje atasheun e Mbrojtjes të SHBA-ve, majorin Juan Murillo

Në auditorin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 08.06.2018, u organizua ceremonia përcjellëse, me rastin e kryerjes së detyrës së atasheut të Mbrojtjes të SHBA-së, e majorit Juan Murillo. Të pranishëm në ceremoni ishin; ministri i FSK-së Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministri Agim Çeku, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralmajori Zymer Halimi, gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneral brigade Irfete Spahiu, gjeneral brigade Naim Haziri, atasheu ushtarak i SHBA-së, kolonel Jeffrey Fisher si dhe zyrtarë të ministrisë, oficerë të NALT-it, të KFOR-it dhe të FSK-së.





Ministri Berisha, pasi përshëndeti të pranishmit e falënderoi atasheun ushtarak të SHBA-ve majorin Juan Murillo për kontributin, përkushtimin dhe angazhimin profesional gjatë kohës së shërbimit të tij në MFSK. Më tej, ministri Berisha u shpreh: ,,Ky takim është organizuar për nder të atasheut të Armatës së SHBA-së, majorit Juan Murillo, i cili po e përmbyll misionin e tij dy vjeçar në mbështetje të MFSK/FSK-së, duke ofruar asistencë profesionale dhe duke zbatuar politikat e shtetit më të fuqishëm në botë, aleatit dhe partnerit tonë kryesor strategjik, sponsorit të lirisë dhe shtetit që po e ndërtojmë sot". Ministri Berisha duke iu drejtuar atasheut të Mbrojtjes, tha:,, Me sado shumë fjalë që përpiqem t'ju vlerësoj Ju dhe punën Tuaj të çmuar që keni bërë për FSK-në gjatë këtij mandati, nuk do të mund t'i themi më mirë nga sa thonë vet gjurmët e punës Tuaj profesionale në procesin e ndërtimit të kapaciteteve mbrojtëse të Kosovës. Ne jemi të inkurajuar në ketë proces për shkakun se mbështetja e SHBA-ve në vazhdimësi na obligon që shumë shpejt të jemi kontribuues në ndërtimin dhe mbështetjen e paqes në vendin tonë, rajon dhe në botë, si objektiv yni i përbashkët". Në fund ministri Berisha i dhuroi majorit Murillo, mirënjohje dhe një dhuratë simbolike, që siç u shpreh ministri: ,,është ikonë e identitetit tonë, e cila shpresojmë të zërë vend në koleksionin e dhuratave të çmuara prej Jush".

Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama falënderoi atasheun e Mbrojtjes të SHBA-ve, majorin Juan Murillo, për angazhimin profesional që ka dhënë për FSK-në. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i dhuroi medalje për Shërbim Meritor, majorit Juan Murilo. Ndërkaq, majori Murillo, falënderoi ministrin Berisha, komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën, si dhe të gjithë stafin e ministrisë dhe FSK-së, për bashkëpunimin dhe mundësinë që i afruan për të kontribuar për FSK-në. Ai veç tjerash shtoi: ,,Gjatë këtyre tri viteve kam mësuar shumë në lidhje me FSK-në dhe jam munduar të jap kontributin tim në avancimin dhe zhvillimin e FSK-së. Para së gjithash, dua të falënderoj FSK-në për organizimin e kësaj ngjarjeje dhe jam i nderuar me gjithë këtë pjesëmarrje sot".

Fetah Zejnullahu përfundoi me sukses shkollimin njëvjeçar në SHBA



Rreshter majori i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) Fetah Zejnullahu, gjatë këtij muaji, diplomoi në El Paso në Akademinë e Rreshter Majorëve në SHBA, duke treguar suksese të jashtëzakonshme si në nivelin akademik, poashtu edhe në atë fizik. Rezultatet e përgjithshme akademike të rreshter majorit Zejnullahut ishin mbi 90%, kurse në aktivitetet fizike ishte i vetmi student ndërkombëtar që në testin e fitnesit fizik arriti mbi 300%. Zejnullahu gjatë shkollimit të tij një vjeçar në SHBA mori pjese në tri gjysmë maratona vrapimi; Bataan March 40 K, Harlbour Challange, Norwegian Foot March 30 K dhe shumë aktivitete tjera fizike e poashtu edhe akademike. Gjithashtu Rreshter majori Zejnullahu përfundoi me sukses kursin Commandan Pre-Command Course, si dhe mori shumë lëvdata dhe shpërblime si nga stafi akademikë po ashtu edhe nga studentët amerikanë. Në United States Army Sergeant Major Academy përfunduan studimet "Klasa 68" me gjithsej 712 nënoficerë nga shumë vende të ndryshme. FSK-ja është përfaqësuar nga nënoficerë të saj në këtë Akademi që nga viti 2012.

FSK-ja, forcë në shërbim të të gjitha komuniteteve

Në bazë të Planit të Veprimit për vitin 2018 të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, FSK-ja, përkatësisht pjesëtarët e Batalionit të Xhenios, më 07 qershor 2018, kanë realizuar një projekt humanitar në Komunën e Graqanicës, i cili kishte të bënte me prerjen e disa plepave të thatë që paraqisnin rrezik për banorët e kësaj ane. Aktivitetet për realizimin e këtij projekti i përcollën nga afër edhe drejtori i Departamentit të BCU-së, Hajrush Kurtaj, majori Limon Salihu dhe zyrtarja nga Zyra për Komunitete në MFSK, znj. Lejla Loci. Projekti është realizuar në aksin rrugor Prishtinë–Gjilan, që kalon nëpër Graqanicë, ku janë prerë disa drurë të thatë të cilët rrezikonin jetën e qytetarëve dhe pengonin qarkullimin e lirë të veturave.

Drejtori i BCU-së, z. Kurtaj, takoi edhe përfaqësuesit e Komunës së Graqanicës dhe disa banorë të komuniteti serb. Ai në takim me ta u shpreh; ,,FSK-ja me kapacitetet e saj gjithmonë do të jetë pranë komunitetit; pa marrë parasysh gjuhën apo fenë. Ne do t'ju dalim në ndihmë të gjithë qytetarëve me projekte që ndikojnë në përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së tyre. Ndërkaq, qytetarët e Graqanicës u shprehen mirënjohjes dhe falënderues ndaj FSK-së. Ne do të jemi pranë komuniteteve; pa marrë parasysh gjuhën apo fenë, tu dalim në ndihmë dhe sidomos realizimin e projekteve të shumta, të cilat janë në të mirë të qytetarëve dhe që ndikojnë në përmisimin e jetës dhe mirëqenies së tyre.

Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake të FSK-së dhe KFOR-it mbajnë takimin për koordinim të aktiviteteve

Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), më 29 qershor 2018, u mbajt takimi i rregullt mujor i Departamentit për Marrëdhënie Civile-Ushtarake të FSK-së dhe udhëheqësve të njësive Marrëdhënieve Civilo-Ushtarake (CIMIC) të KFOR-it që veprojnë në Kosovë. Me këtë rast, drejtori i Departamentit Civilo-Ushtarak, Hajrush Kurtaj i cili shprehu mirënjohjen për angazhimin dhe punën e vazhdueshme të CIMIC-ut të KFOR-it për përfshirjen e FSK-së në mbështetjet, projekte dhe aktivitete që realizon KFOR-i në të mirë të qytetarëve në gjithë territorin e Kosovës. Projektet dhe mbështetjet që FSK-ja ka realizuar në Maj–Qershor 2018, u prezantuan nga zyrtari i CIMIC-ut të FSK-së, Agron Durmishi, i cili me theks të veçantë përmendi aktivitetet si; organizimi i kampit rinorë, angazhimi i FSK-së në rivarrimin e dëshmorëve në fshatin Marinë, përfundimi i projektit në prerjen e drunjëve në Graçanicë, mbështetjen me tenda për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës si dhe angazhimin e FSK-së në shënimin e Ditës së Tokës etj. Nga ana e KFOR-it u vlerësua lartë angazhimi i FSK-së në mbështetjen dhe realizimin e projekteve humanitare për të gjitha komunitetet pa dallim. U konfirmua se CIMIC-u i KFOR-it do ta mbështes gjithnjë CIMIC-un e MFSK-se ne realizimin e projekteve të përbashkëta.

FSK-ja pjesë e aksionit për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit

FSK-ja vite me radhë ka mbështetur aksionet për pastrimin e mjedisit kudo në Kosovë. Edhe kësaj radhe, FSK-ja ka angazhuar personel dhe pajisje xheniere në mbështetje të aksionit me moton "Ta pastrojmë Kosovën", në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit.

Manifestimi qendror për shënimin e kësaj dite u mbajt në fshatin Plemetin të Obiliqit, më 06.06.2018, ku të pranishëm ishin ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Albena Reshitaj, kryetari i Obiliqit Xhafer Gashi, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale gjeneral brigade Naim Haziri, ambasadori i Gjermanisë Christian Heldt, komandanti i Policisë së Kosovës për Obiliqin Sejdi Zeqiri, organizatori i kësaj ngjarjeje Luan Hasanaj, nxënës dhe qytetarë të shumtë të Komunës së Obiliqit.



Në fjalën e tij, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi theksoi: "Sot kam kënaqësinë që së bashku me ushtarë, nënoficerë dhe oficerë po e mbështesim këtë aksion në shërbim të qytetarëve tanë. Obiliqi ka qenë dhe vazhdon të mbete prioritet ynë.

Urime Dita Ndërkombëtare e Mjedisit, uroj që të kemi një ambient më të pastër në të gjithë Kosovën". Organizatori i manifestimit z Luan Hasanaj i falënderoi të gjithë për mbështetjen e këtij aksioni. "Pjesëmarrja e juaj sot këtu, institucione dhe qytetarë, tregon se sa i rëndësishëm është ambienti, prandaj ju bëj thirrje të gjithëve që ta ruani dhe ta mbroni ambientin tuaj në të mirë të gjithë qytetarëve. Urime Dita Ndërkombëtare e Ambientit". Në fund nga ministrja e Mjedisit u ndanë mirënjohje për të gjitha institucionet që kanë ndihmuar në realizimin e këtij aksioni.

Pjesëtarët e FSK-së u japin ndihmën e parë dy personave të aksidentuar në komunikacion



Një ekip i Forcës së Sigurisë të Kosovës, përkatësisht të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza, përgjatë rrugës Prishtinë–Ranillug, afër Ranillugut, dje (27.06.2018) i ofruan ndihmën e parë në vendin e aksidentit dy personave civil të lënduar si pasojë e aksidentit rrugor, si dhe janë përkujdesur për të njëjtit derisa autoambulanca dhe personali mjekësor i ka evakuuar për në spital. Ekipi i FSK-së, ishte duke udhëtuar për në Komunën e Ranillugut, ku FSK-ja rregullisht merr pjesë në takimet zyrtare për siguri në komunat e Kosovës. Pjesëtarët e FSK-së janë të trajnuar për ofrimin e ndihmës së parë, dhe ndihmës së parë në vendngjarje. Këto njësi shpesh kanë intervenuar dhe kanë shpëtuar jetë njerëzish, pra në raste aksidentesh, etj.

Batalioni i Tretë i Reagimit të Shpejtë zhvilloi ushtrimin „Skifteri 01"



Kompania 3C e Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë të FSK-së ka përmbyllur trajnimin e gjenerimit të forcës i cili është zhvilluar nga 3 prilli deri më 28 qershor 2018, në territorin e dy komunave atë të Mitrovicës dhe Vushtrrisë. Kompania 3C të gjitha intervenimet i ka realizuar nga baza e përhershme e Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë pra, nga kazerma ,,Minatori'' Mitrovicë. Operacionet përfundimtare të ushtrimi fushorë ,,Skifteri 01'' i përcolli edhe komandanti i Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë, nënkolonel Sylejman Cakaj, i cili i përgëzoi pjesëtarët për profesionalizmin, gatishmërinë dhe motivin e treguar gjatë realizimit të këtij ushtrimi, si dhe kërkoi nga ata të vazhdojnë më përkushtim kryerjen e detyrave edhe në të ardhmen. Qëllimi i këtij Ushtrimi ishte testimi i gatishmërisë së personelit të Kompanisë 3C në intervenime gjatë operacioneve. Në këtë ushtrim ka marrë pjesë edhe Kompania 3B me 25 pjesëtarë si forcë opozitare, si dhe Kompania Mbështetëse dhe Ekipi Mjekësorë. Për më tepër ky ushtrim fushorë dëshmon që Batalioni i Tretë është i gatshëm dhe ka kapacitete që të zhvillojë operacione për t`u dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës në Zonën e përgjegjësisë të cilën e mbulon.

Qendra e Studimeve Universitare e FSK-së ka realizuar ushtrimin fushor "Kampi i Avancuar i QSU-së"

Qëllimi i këtij ushtrimi ka qenë përgatitja taktike në operacionet urbane ofensive dhe mbrojtëse, si dhe testimi i gatishmërisë fizike dhe psikike të kadetëve. Gjatë realizimit të ushtrimit fushor, kadetët e QSU-së, u përballen edhe me temat si: operacionet urbane ofensive dhe mbrojtëse, navigim tokësor ditën dhe natën, patrullime, reagimi në kontakt, etj. Për të përcjellë nga afër ushtrimin fushor të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare (QSU) më 7 qershor 2018, ishin: Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, zëvendëskomandanti i Brigadës së Mbështetjes kolonel Avdi Rraci, komandanti i Kampit Bondsteel, koloneli Nick Ducich si dhe oficerë të lartë të FSK-së. Fillimisht për të pranishmit, kapiteni Vegim



Krelani, ushtrues detyre i komandantit të Qendrës për Studime Universitare, bëri një njoftim rreth angazhimit në ushtrimin fushor, qëllimin e këtij ushtrimi dhe njoftoi të pranishmit për aktivitetet, të arritur dhe sfidat me të cilat janë përballur kadetët e katër gjeneratave, gjatë këtyre ditëve në kampin fushor në Zhegoc.

Komandanti i FSK-së vlerësoi lartë punën e kadetëve në realizmin e ushtrimit dhe theksoi se: "Aktivitetet e juaja këtu kanë përparësitë por edhe sfidat, prandaj ju pas përfundimit do të dilni me të gjeturat rreth mësimeve të mësuara, kështu do të kemi mundësi të përkushtohemi në ushtrimet e radhës që mos të përsëritën këto mësime të mësuara. Unë ju përgëzoj për punën dhe sukseset, e di që gjatë punës dalin edhe probleme dhe prandaj jemi këtu, për të parë nga afër punën tuaj. Këto aktivitete që po i zhvilloni tani në situatë paqeje kërkohet të jenë sa më reale, që në të ardhmen nëse paraqitet nevoja, të jeni të përgatitur të përballeni me sfidat".

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë në vazhdimësi, ndau një mirënjohje për pjesëtarin e FSK-së Rreshter Fadil Rashiti, i cili ka lejuar mbajtjen e këtij ushtrimi për vite me radhë në pronat e tij dhe të familjes së tij. Kadetët për të pranishmit raportuan për angazhimin dhe demonstruan një ushtrim i cili u përcoll me interesim nga mysafirët e ftuar.

Batalioni i Dytë i BRSH-së përfundoi me sukses ushtrimin „Reagimi i përbashkët 2018"

Kompania 2C e Batalionit të Dytë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH), në bazë të kalendarit vjetor të stërvitjes, ka realizuar trajnimin e brendshëm tre mujor, kurse më 25.06.2018, ka zhvilluar edhe ushtrimin fushor 48 orësh "Reagimi i Përbashkët-2018", në Komunën e Gjakovës. Angazhimi i komandantit të Batalionit të Dytë, majorit Valdet Berisha së bashku me pjesëtarët e FSK-së, në këtë trajnim është vlerësuar lartë nga zv. komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Xhevahir Geci, komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë gjenerali Fadil Hadergjonaj, kryetari i komunës Ardian Gjini, oficerë të Brigadës Shumëkombëshe të Lindjes dhe kontrollues-vëzhgueseve të KDS-së. Pjesë e këtij ushtrimi fushor kanë qenë njësitë e specializuara të RMC/FSK-së, si Kërkim-Shpëtim (KSH) në Male, Ujëra, Urbane, Materiet Kimike-Atomike-Biologjike (MKAB) dhe Njësia Ndërlidhëse në Reagim në Kriza (NJNRK) si dhe autoritetet lokale përfshirë Drejtorinë për Emergjenca, Policinë e Kosovës, Kryqin e kuq, Zjarrfikësit, QKMF-Gjakovë, si dhe Brigadën Shumëkombëshe të Lindjes. Gjatë këtij ushtrimi që ishte produkt i trajnimit tre mujor, pjesëtarët e FSK-së dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht në operacionet ushtarake siç janë: Rikonicion të terrenit, Patrullimet me blinda, kordon-kërkim, Mbrojtje gjatë marshimeve rrugore, perimetër të sigurisë, Kërkim-shpëtim në ujëra, male, urban dhe MKABK (evakuim me helikopter), Aksident trafiku e tjera. Gjatë planifikimit dhe zbatimit të këtij ushtrimi fushor çdo detaj ka funksionuar në bazë të procedurës së udhëheqjes së trupave. Për më tepër ky ushtrim dëshmoi që BRSH-ja është përgatitur dhe ka kapacitet të mjaftueshme për realizimin e operacioneve të sigurisë/operacioneve humanitare në koordinim me autoritetet lokale dhe forcat e NATO-s, për të real-



izuar qëllimin e komandantit të Batalionit të Dytë. Qëllimi i trajnimeve është mbajtja e nivelit të gatishmërisë të Batalionit të dytë të FSK-së dhe bashkëpunimi me autoritetet lokale, njësitë e specializuara të FSK-së dhe KFOR-in.

FSK-ja mbështet Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut



Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut në Kosovë, për nder të Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut (14 qershorit) sot (20.06.2018) në sheshin ,,Nënë Tereza" në Prishtinë, ka organizuar javën e dhurimit vullnetar të gjakut. Java e dhurimit vullnetar të gjakut ka filluar më 18.06.2018 dhe do të përfundojë më 22.06.2018. Për rëndësinë që ka sigurimi në kohë i gjakut dhe produkteve të tij, gjatë kësaj jave do të jetë në fokus edhe falënderimi për të gjithë dhuruesit vullnetarë të gjakut të cilët me dhurimin e gjakut të tyre shpëtojnë jetë çdo ditë.

Këtij aksioni vullnetar iu bashkuan shumë pjesëtarë të FSK-së, qytetarë të shumtë, kalimtarë të rastit, por edhe grupe të organizuara që me vullnetin e mirë i ishin përgjigjur këtij aksioni

FSK-ja, si çdo vit edhe këtë vit e ka mbështetur Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut me mjete logjistike. Në sheshin ,,Nënë Tereza" ka ngritur një tendë për të gjithë vullnetarët që dhurojnë gjak. Aksionit iu përgjigjën një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së, të cilët edhe përgjatë vitit në mënyrë të organizuar dhurojnë gjak. Qindra doza gjak grumbullohen nga këta pjesëtarë për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës.

FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 71 • 8 Gusht 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

Ministri Rrustem Berisha merr pjesë në konferencën e ministrave të mbrojtjes "SHBA-Karta e Adriatikut-A5" në Kroaci



Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Rrustem Berisha, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, z. Damir Krstiçeviq, po merr pjesë në punimet e konferencës speciale "SHBA-Karta e Adriatikut A-5", që po mbahet në Zagreb të Kroacisë.

Në këtë konferencë po merr pjesë sekretari i mbrojtjes i SHBA-ve, James Mattis, ministrat e mbrojtjes të Kroacisë, Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Qëllimi i mbajtjes së konferencës ,,SHBA-Karta e Adriatikut A5" është integrimi regjional, ballafaqimi me ndikimet e akterëve të jashtëm dhe ndarja e përgjegjësive dhe barrës. Delegacioni i Kosovës, me këtë rast e ka njoftuar sekretarin e mbrojtjes të SHBA-ve, James Mattis dhe të gjithë ministrat e mbrojtjes të regjionit, për të arriturat e FSK-së, ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin në aspektin profesional. Në këtë konferencë u kërkua që Kosova të jetë anëtare me të gjitha të drejtat e plota, si dhe Kosova ka ofruar gatishmërinë për të kontribuar në misione jashtë vendit. Gjithashtu me theks të veçantë u bisedua edhe tema e transformimit të FSK-së, në forca të armatosura, si kontribuuese e sigurisë në regjion dhe në botë përkrah partnereve tanë të sigurisë.

Nga të gjithë të pranishmit u kërkua, që i gjithë regjioni duhet të jetë bashkëpunues në ballafaqimin me kërcënimet bashkëkohore dhe të punojmë së bashku në ngritjen e kapaciteteve të përbashkëta. Në veçanti u theksua që A5, duhet të zgjerohet edhe me shtete tjera të regjionit, duke e përfshirë edhe Kosovën si anëtare me të drejta të plota.



Gjatë konferencës ministri i FSK-së, Rrustem Berisha takoi sekretarin e mbrojtjes të SHBA-ve James Matis, po ashtu pati takime bilaterale edhe me ministrat e mbrojtjes të Kroacisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, ku u konfirmua shkallë e lartë e bashkëpunimit në mes të ministrive përkatëse. Konferenca speciale ,,SHBA-Karta e Adriatikut A5", pritet që sot t'i përfundojë punimet.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama qëndroi për vizitë zyrtare në Turqi



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të komandantit të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneralit Hulusi Akar, nga data 01-05 korrik 2018, qëndroi për vizitë zyrtare në Turqi. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama është pritur nga komandanti i Forcave të Armatosura të Turqisë, gjenerali Hulusi Akar, ku të dy gjeneralët gjatë takimit kanë biseduar për bashkëpunimin e deritashëm si dhe për mundësinë e rritjes së këtij bashkëpunimi në të ardhmen edhe në fushat tjera, si: shkollimit, edukimit dhe stërvitjeve, e që janë me interes të përbashkët.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, pasi e ka falënderuar komandantin e Forcave të Armatosura të Turqisë, gjeneralin Akar, për mbështetjen e vazhdueshme të Ushtrisë së Turqisë në trajnimin dhe avancimin e FSK-së, si një forcë kredibile, gjithëpërfshirëse dhe të gatshme, si dhe për shkollimin e kadetëve në akademitë dhe shkollat ushtarake të Turqisë, e ka njoftuar edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si; shkollimet, trajnimet dhe bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtar. Komandanti i FSK-së, gjatë qëndrimit në Turqi, realizoi vizitë zyrtare edhe në Universitetivn e Mbrojtjes së Turqisë, ku është pritur nga stafi i larte i këtij institucioni ushtarak.

Gjenerali Rrahman Rama ka biseduar me udhëheqësit e Universitetit të Mbrojtjes për mundësinë e shkollimit dhe edukimit të pjesëtarëve të FSK-së, në këtë institucion ushtarak në të ardhmen, ku një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së, kanë diplomuar në këtë institucion ushtarak. Gjatë takimit u tha se bashkëpunimi i FSK-së me Forcat e Armatosura të Turqisë është shumë i mirë dhe ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen duke përfshirë edhe fushat tjera që janë me interes të përgjithshëm për të dyja palët. Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, sot pritet ta përfundojë vizitën zyrtare në Republikën e Turqisë.

FSK-ja pajiset me automjete taktike amerikane „Hamvi"

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në një ceremoni rasti, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe ambasadori i SHBA-ve, z. Greg Delavie, më 17.07.2018, nënshkruan aktin final të kontratës për furnizim me automjete shumë funksionale ushtarake me lëvizshmëri të lartë (HMMWV) nga Qeveria e Republikës së Kosovës me kompaninë amerikane ,,AM General" për furnizim të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, duke falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, theksoi se Forca e Sigurisë së Kosovës është një trupë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe është shembulli më i mirë i ecjes së përbashkët të Kosovës me SHBA-të dhe NATO-n:

vazhdon në faqen pesë



Deklaratë për media e ministrit Rrustem Berisha

FSK-ja ka qenë, është dhe do të jetë e hapur për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë



Forca e Sigurisë së Kosovës, ditëve të fundit është duke u përballur me dukurinë e kërkesave për largim nga FSK-ja të disa pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë serb. Sipas vlerësimeve të MFSK, këto kërkesa për largim vijnë si pasojë e sulmeve të qëllimshme që i janë bërë FSK-së, përkatësisht pjesëtarëve të komunitetit serb dhe janë tentim për të dëmtuar arritjet dhe zhvillimin e FSK-së si dhe imazhin e saj si institucioni më i besueshëm në vend për vite me radhë. Ne ndjejmë keqardhje për pjesëtarët tanë të cilët nuk janë lejuar të vendosin lirshëm për vazhdimin e karrierës profesionale, të ardhmes së tyre, duke ndikuar negativisht direkt në mirëqenien e tyre dhe të familjeve të tyre.

Pjesëtarët e FSK-së nga komuniteti serb kanë qenë shumë mirë të integruar në nivel të përgjegjësive dhe detyrave të tyre, prandaj shantazhet dhe kërcënimet e bëra janë të papranueshme, janë shkelje e të drejtave themelore të njeriut. Diversiteti etnik dhe profesionalizmi i Forcës së Sigurisë së Kosovës, është një vlerë që është e njohur dhe e pranueshme nga miqtë tanë ndërkombëtar dhe shtetet anëtare të NATO-s, dhe kjo vlerë është duke ju penguar atyre që nuk ja dojnë të mirën Kosovës dhe qytetarëve të saj, pavarësisht se cilit komunitet i takojnë. FSK, do të vazhdojë në përmbushje të misionit dhe zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve operacionale si dhe angazhimin për përfundimin e tranzicionit në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK), si forcë moderne mbrojtëse për Kosovën dhe popullin e saj pa asnjë dallim.

Rruga e Kosovës dhe e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk do të ndalet. FSK-ja ka qenë, është dhe do të jetë e hapur për të gjitha komunitet që jetojnë në Kosovë dhe gjithherë do të jetë në shërbim të qytetarëve të saj.

Gatishmëri e dyanshme për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe MM të Irlandës



Sot, (10.07.2018) ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha priti ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Irlandës, z. Paul Kehoe. Në takimin e përbashkët në mes të dy delegacioneve, ministri Berisha së bashku me ministrin e Republikës së Irlandës, zotin Kehoe biseduan për bashkëpunimin e dyanshëm në mes të Kosovës dhe Republikës së Irlandës, MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Irlandës si dhe për zhvillimet në fushën e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Ministri Berisha, ka falënderuar ministrin e Irlandës Paul Kehoe për bashkëpunimin e deri tashëm dhe për ndihmën që Irlanda ka dhënë dhe po jep për Kosovën, duke e njoftuar me zhvillimet e përgjithshme në Ministri dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Pas takimit të dy ministrat dhanë nga një deklaratë për media.

Ministri Rrustem Berisha në fjalën e tij ndër të tjera tha: ,,Patëm nderin dhe kënaqësinë që ta presim ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Irlandës, z. Paul Kehoe të cilin e njoftuam në pika të shkurta me të arriturat e FSK-së, me progresin e FSK-së, sidomos me integrimin e komuniteteve jo shumicë, pjesëmarrjen e gjinisë femërore në strukturat e FSK-së, me objektivat dhe synimet tona si dhe me procesin e transformimit të FSK-së në FAK. Në të njëjtën kohë e falënderuam ministrin e mbrojtjes Kehoe, për mbështetjen dhe për përkrahjen që na kanë dhënë në rrugëtimin tonë drejt lirisë dhe sidomos pas luftës, e që vazhdojnë të japin edhe tani në kuadër të KFOR-it. Gjithashtu e falënderuam ministrin për faktin që Irlanda ka qenë ndër të parët që e ka njohur pavarësinë Kosovës.

Biseduam edhe për avancimin e bashkëpunimit të dy ministrive në fushën e sigurisë dhe për modelet e bashkëpunimit, dhe se shumë shpejtë do ta nënshkruajmë memorandumin e bashkëpunimit në mes të dy ministrive në fushën e sigurisë".

Ndërsa, ministri i Republikës së Irlandës Paul Kehoe falënderoi ministrin Berisha për pritjen e përzemërt dhe para mediave ndër të tjera deklaroi: ,,Jam i nderuar që jemi siç e përmendi ministri Berisha, ndër vendet e para që kemi njohur Pavarësinë e Kosovës. Është vizita e ime e parë në Kosovë, qëllimi i saj ishte vizita e pjesëtarëve të KFOR-it Irlandez, gjithashtu kam nderin që të jem këtu në mesin e juaj. Me ministrin biseduam për çështje të ndryshme siç është liberalizimi i vizave, integrimi në Bashkimin Evropian, në Kombet e Bashkuara etj. Ne do të ju afrojmë ndihmën tonë të pakursyer në këto procese, dhe do të jemi gjithmonë pranë jush posa t'i plotësoni kërkesat relevante.

Gjatë rrugëtimit e pashë që Kosova ka një të ardhme të ndritshme bazuar në progresin e bërë. Me ministrin biseduam edhe për avancimin e bashkëpunimit, veçanërisht në përgatitjen e memorandumin të bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive". Në takim të pranishëm ishin edhe Shkëlzen Syla, sekretar i Përgjithshëm në MFSK, Jashar Ramadani shef i Kabinetit të Ministrit, majori Hisen Berisha këshilltar ushtarak i Ministrit, Zoja Lleshi-Berisha këshilltare politike e Ministrit, Ilir Murtezi këshilltar politik i Ministrit, Sinan Geci nga Departamenti për Bashkëpunim dhe Siguri, Ibrahim Shala Departamenti për Marrëdhënie me Publikun kurse nga delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes të Irlandës, ministrin e shoqëronin; Pat Kelly ambasadori i Irlandës, Maurice Quinn sekretar i Përgjithshëm, John Coughlan këshilltar i Ministrit, znj. Cliona O'Sullivan sekretare private e Ministrit, zv.admiral Mark Mellett shef i stafit në Ministrin e Mbrojtjes dhe Deirdre Carbery kapiten.

Gjermania konfirmon mbështetjen për FSK-në dhe Kosovën



Zëvendësministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe koloneli Jeton Dreshaj, që nga data 16.07.2018, po qëndrojnë për një vizitë zyrtare në Qeverinë Federale të Gjermanisë.

Zëvendësministri Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama, gjatë vizitës në Qeverinë e Gjermanisë kanë realizuar takime të përbashkëta ku kanë biseduar për zhvillimet dhe arritjet e përgjithshme të FSK-së, avancimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, si dhe për planet për avancim dhe bashkëpunim në të ardhmen.

Gjatë takimeve të përbashkëta, zyrtarët e lartë të Qeverisë Gjermane kanë konfirmuar mbështetjen për FSK-në dhe Kosovën, duke përkrahur zhvillimin e kapaciteteve profesionale të institucioneve të Kosovës për siguri me qellim të thellimit të bashkëpunimit me Gjermaninë dhe NATO-n, në këtë aspekt. Delegacioni i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK) është pritur nga sekretari i shtetit z. Thomas Silberhorn, zëvendësministër në Ministrinë Federale të Mbrojtjes, kurse dje delegacioni i MFSK-së është pritur nga znj. Betinna Cadenbach, drejtoreshë për Politikat e Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe drejtori për Planifikim në Ministrinë e Mbrojtjes, gjenerali Erhard Bühler Delegacioni ka vizituar edhe Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Gjatë takimeve në Qeverinë e Gjermanisë delegacioni i MFSK-së bisedoi me mikpritësit për avancimin dhe thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Gjermanisë dhe në këtë kuadër edhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës me Ushtrinë e Gjermanisë.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Delegacioni i lartë i FSK-së vizitoi Ministrinë e Jashtme të Francës



Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) z. Burim Ramadani, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe oficeri i lartë kolonel Jeton Dreshaj, më 19 korrik 2018, qëndruan për vizitë zyrtare në Republikën e Francës. Delegacioni i MFSK-së i shoqëruar edhe nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Paris, z. Qëndrim Gashi u prit nga z. Thomas Bertin, drejtor për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës.

Në takimet që zhvilloi delegacioni i FSK-së në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Ministrinë e Mbrojtjes të Francës, janë diskutuar arritjet e FSK-së, bashkëpunimi dypalësh dhe avancimi i marrëdhënieve ndërmjet dy ministrive. Zv. ministri Ramadani dhe gjeneral Rama në takimet e tyre me zyrtarët francez biseduan edhe për sigurinë në Kosovë dhe rajon, si dhe për të ardhmen e FSK-së dhe mundësitë që FSK-ja në të ardhmen të bëhet pjesë e Operacioneve Paqeruajtëse krahas ushtrive të vendeve të NATO-s. Në të gjitha takimet e delegacionit të MFSK-së me zyrtarët francez u arrit konstatimi se bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Francës për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes është kontribut për partneritetin e përgjithshëm midis dy vendeve si dhe për sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Shefi i Shtabit të KFOR-it, gjenerali Powell vizitoi KDS-në



Më 19 korrik 2018, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) gjeneral brigade Irfete Spahiu priti shefin e Shtabit të KFOR-it në Kosovë gjeneral brigade Lawrence Powell. Në takimin e përbashkët në mes të dy gjeneralëve u bisedua për bashkëpunimin e dyanshëm ndërmjet FSK-së dhe KFOR-it, me theks të veçantë për bashkëpunimin në fushën e stërvitjes dhe shkëmbimit të përvojave. Gjeneral Spahiu dhe gjenerali Powell biseduan edhe për të arriturat e FSK-së dhe rolin e KDS-së në zhvillimin dhe profesionalizimin e pjesëtarëve të FSK-së, si dhe mundësitë e bashkëpunimit si brenda ashtu edhe me partnerët strategjikë, si dhe për objektivat për zhvillimin dhe avancimin e KDS-së në të ardhmen. Gjeneral Spahiu ka falënderuar gjeneralin Powell për bashkëpunimin e deritashëm dhe për ndihmën që KFOR-i ka dhënë dhe po jep për Kosovën si dhe kontributin në ndërtimin dhe zhvillimin e FSK-së, si me pajisje po ashtu edhe me trajnime. Ajo gjithashtu e njoftoi gjeneralin Powell edhe me zhvillimet e përgjithshme që janë duke ndodhur në KDS dhe synimet për të ardhmen. Takimi përfundoi me shkëmbimin e dhuratave mes gjeneralëve të cilët shprehën gatishmërinë që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Kosova dhe Italia thellojnë bashkëpunimin në siguri dhe mbrojtje

Zëvendësministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 24 korrik 2018, kanë qëndruar për vizitë dyditore në Romë. Delegacioni i MFSK-së është pritur nga niveli i lartë i Qeverisë italiane dhe Forcat e Armatosura të Italisë. Në takimin e zv. ministrit Ramadani dhe komandantit Rama me zëvendësministrin italian të Mbrojtjes, z. Raffaele Volpi, u diskutua për objektivat e Kosovës për anëtarësim në NATO, thellimin e bashkëpunimit dypalësh me Italinë, arritjet e FSK-së, planin gjithëpërfshirës për transformimin e FSK-së në ushtri, si dhe për vullnetin e Kosovës për t'i dërguar trupat e FSK-së në ndihmë të popujve në zona të ndryshme të krizave nëpër botë.

Gjithashtu, dje, më 23 korrik, delegacioni i MFSK-së është pritur nga nënadmirali Giuseppe Dragone, komandant i Shtabit të Përbashkët Italian të Operacioneve. Delegacioni i FSK-së me nënadmiralin Dragone kanë diskutuar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit dhe angazhimet e përbashkëta ndërmjet Kosovës dhe Italisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe për gatishmërinë e Kosovës për të marrë pjesë në Operacione Paqeruajtëse nëpër botë krahas Forcave të Armatosura Italiane. Delegacioni i MFSK-së ka zhvilluar vizitë edhe në Ministrinë e Jashtme të Italisë me drejtorin për Ballkanin Perëndimor dhe drejtorin për NATO, ku ndër të tjera me zyrtarët e MPJ-së u diskutuan marrëdhëniet e Kosovës me Italinë dhe me NATO-n.



Gjenerali Naim Haziri vizitoi Komandën e Mbështetjes të FA të Republikës së Shqipërisë



Bazuar në planin e bashkëpunimit dypalësh me Republikën e Shqipërisë dhe me ftesë nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) komandanti i brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) gjeneral brigade Naim Haziri, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Brigadës së Mbështetjes Operacionale nënkolonel Sami Hajrullahu, shefi i G3 i kësaj brigade, major Astrit Halilaj, më 16 korrik 2018, zhvilluan një vizitë pune dyditore në Komandën Mbështetëse të FARSH. Në këtë vizitë gjeneral Haziri shoqërohej edhe nga atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës i akredituar në Tiranë, kolonel Bashkim Shillova. Gjeneral brigade Naim Haziri u prit nga komandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gasper Lala dhe shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse kolonel Beqir Tafili. Në takim u fokusuan në fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak midis Komandës Mbështetëse dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, përkatësisht BMO-së, për trajnim dhe stërvitje në fushën e operacioneve për emergjencat civile, në rast të katastrofave natyrore si: zjarrfikje, kërkim- shpëtim e deri në ndërtim të urave. Gjeneral Haziri po ashtu u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-s gjeneral brigade Bardhyl Kollqaku i cili solli në vëmendje kontributin e FSK-së për Shtetin Shqiptar sa herë që është kërkuar në rastet e katastrofave natyrore. Gjeneral Haziri falënderoi gjeneral brigade Kollqaku si dhe komandantin e Komandës Mbështetëse dhe stafin e tij për pritjen e ngrohtë duke kërkuar që bashkëpunimi midis Brigadës së Mbështetjes Operacionale të FSK-së dhe Komandës Mbështetëse të FARSH-it të jetë i vazhdueshëm dhe i pandërprerë. Gjeneral Haziri tha se "FSK-ja tani dhe në të ardhmen do jetë prodhuese e sigurisë për vendin, rajonin dhe më gjerë. Ne ndihemi jashtëzakonisht mirë që si institucion i ri kemi arritur të japim diçka për ushtritë partnere në fushën e trajnimeve të kërkim- shpëtimit, gjë të cilën do vazhdojmë të ofrojmë edhe në të ardhmen përmes Qendrës së Kërkim-Shpëtimit në Regjimentin e Mbrojtjes Civile. Duke pasur parasysh kapacitet aktuale që kemi si njësi bazuar në mision dhe në bashkëpunim për forcimin e tyre, do të jemi në gjendje që në kohë sa më të shkurtër t'iu përgjigjemi kërkesave në shërbim të qytetarëve për të dy vendet".

Krivollak - Maqedoni

Kadetët e FSK-së marrin pjesë në ushtrimin fushor “Kampi veror 2018” në Krivollak të Maqedonisë



Në poligonin stërvitor ushtarak në Krivollak të Republikës së Maqedonisë, sot (06.07.2018) kadetët e shteteve pjesëmarrëse me sukses përfunduan operacionet përfundimtare në kuadër të ushtrimit 12 ditor „Kampi veror 2018'', ku krahas kadetëve të 11 shteteve si: SHBA-ja, Gjermania, Shqipëria, Maqedonia, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi, Kosova, Rumania, Norvegjia dhe kadetët e FSK-së, të cilët demonstruan me sukses aftësitë e tyre profesionale si dhe nivelin e gatishmërisë. Ushtrimin fushor të kadetëve „Kampi veror 2018'' e përcollën nga afër edhe gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, shef i Departamentit për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), kolonel Mehmet Lladrovci zëvendës komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), kapiten Adem Preteni zëvendës komandant i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së (QSU),etj. Me këtë rast, gjeneral Nazmi Brahimaj, në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka përgëzuar të gjithë kadetët e FSK-së, pjesëmarrës në ushtrim për motivimin, disiplinën, profesionalizmin dhe ndërveprimin me kadetët në ambient ndërkombëtarë me të cilin këta kadetët do të stërviten dhe trajnohen edhe në të ardhmen.

Në ditën e fundit të ushtrimit fushor, kadetët e të gjitha vendeve pjesëmarrëse, gjatë demonstrimit, përbënin një batalion shumëkombësh që ishin të ngarkuar me detyra të operimit dhe realizimit të tyre në terren. Ushtarët dhe eprorët pjesëmarrës treguan një nivel të lartë të angazhimit, veprimit dhe koordinimit në mes tyre, duke vepruar si njësi unike në realizimin e detyrave të përcaktuara nga skenari i ushtrimit. Ushtrimi fushor “Kampi veror 2018” ka karakter ndërkombëtar dhe organizohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe Akademia Ushtarake e Maqedonisë, në të cilin për çdo vit po marrin pjesë kadetët e vende të ndryshme të rajonit e më gjerë, të menaxhuar nga instruktorë të NATO-s dhe të Partneritetit për Paqe (PFP). Kadetët e FSK-së, pjesëmarrës në “Kampin veror 2018”, edhe këtë vit u dalluan me paraqitjen e tyre të shkëlqyeshme si në operacionet individuale dhe ato kolektive.




Certifikohen zhytësit e FSK-së për kërkim-shpëtim në ujëra



Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në Pomozatin, më 29.06.2018, është mbajtur ceremonia e certifikimit të 12 pjesëtarëve të FKS-së, të cilët kanë përfunduar me sukses kursin e nivelit bazik të zhytjes në ujë. Gjatë këtij trajnimi kadetët kanë përfunduar pjesën teorike brenda në klasë, ku kanë mësuar procedurat e sigurisë, njohuritë rreth pajisjeve të zhytjes dhe komunikimin nën ujë. Faza tjetër e trajnimit është mbajtur në pishinë, në Banjë të Malishevës, ku për herë të parë studentët kanë përjetuar përvojën praktike të veshjes si dhe notit me pajisje të zhytjes. Fazën e tretë dhe të fundit të trajnimit, studentët e kryen në Batllavë, gjatë qëndrimit njëjavor; ku aty studentët kanë fituar praktikën dhe përvojën e zhytjes në ujëra të ndotura ku shikueshmëria ka qenë shumë e dobët. Gjatë testimit të rreptë, studentët për detyrë kanë pasur kryerjen e një numri të procedurave të sigurisë gjersa zhyteshin në një thellësi minimale prej 5m nën ujë. Gjatë testimit, studentët u vizituan nga admirali Kilrain i SHBA-ve dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Certifikatat janë ndarë nga koloneli Shaip Haziri, komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), koloneli Selim Troci nga Ushtria e Republikës së Shqipërisë dhe njëherësh drejtor i Qendrës së Kërkim-Shpëtimit, Major Connor, Atasheu nga Ambasada e SHBA-ve si dhe drejtori i Qendrën së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim. Ky kurs ka qenë historik për tërë FSK-në. Për herë të parë, nga komuniteti joshumicë, 2 pjesëtarë të FSK-së nga komuniteti serb janë kualifikuar si zhytës. Gjithashtu për herë të parë, duke u ballafaquar me stresin mendor dhe tendosjen e të qenit anëtar i kërkim-shpëtimit profesional si dhe një zhytës, studentët iu nënshtruan një trajnimi specifik lidhur me atë se si të menaxhojnë traumat psikologjike. Ky modul u tregua shumë i suksesshëm andaj që prej tash është përfshirë në të gjitha kurset që ofrohen nga QTKSH-ja.

Në përmbushjen e detyrave të tij, sa të ndjeshme po aq edhe fisnik. “ Nderimi ndaj historisë, dëshmorëve dhe të kaluarës sonë të lavdishme është nderim për lirinë, shtetin e Kosovës dhe të ardhmes tonë. Kjo uniformë që sot bartin vajzat dhe djemtë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka kaluar një rrugë të gjatë e të mundimshme për të ardhur deri këtu ku jemi sot, andaj çdo angazhim yni për të ndihmuar në projektet tuaja për komplekset memorialë në Kosovë, është një nder për ne”. Ndërkaq, drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Kompleksëve Memoriale, Bislim Zogaj e falënderoi përzemërsisht ministrin Berisha për pritjen dhe përkrahjen.







Albian Ajvazi shpallet studenti më i mirë ndërkombëtar në shkollën e Adjutantëve Gjeneralë të Ushtrisë së SHBA-ve

Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, togeri Albian Ajvazi, këshilltar ushtarak i komandantit të Forcës Tokësore të FSK-së, më 20.07.2018, shpallet studenti më i mirë ndërkombëtar, në trajnimin “Kursi për Kapiten të Karrierës për Adjutant Gjeneral” që u realizua nga shkolla e Adjutantëve Gjeneralë të Ushtrisë së SHBA-ve. Në këtë shkollë, përveç studentëve nga ushtria amerikane, pjesëmarrës ishin edhe oficerë nga Kosova, Egjipti, Jordania, Indonezia dhe Rumania. Në vlerësimin e përgjithshëm nga ushtria amerikane shkruhet: Togeri Albion Ajvazi demonstroi një kuptim të plotë të kompetencave të burimeve njerëzore, si dhe funksioneve të tjera thelbësore të mbështetjes së burimeve njerëzore. Ai e përfaqësoi Kosovën në mënyrë të jashtëzakonshme në Shtetet e Bashkuara. Toger Ajvazi, gjatë shkollimit në SHBA, ka zgjeruar njohuritë ushtarake në temat e përgjithshme si: Menaxhimi i sistemeve të burimeve njerëzore; mbështetja operacionale dhe taktike; shërbimet esenciale dhe menaxhimi i gatishmërisë së personelit; zhvillimi i planifikimit dhe operacioneve në kuadër të burimeve njerëzore dhe mbështetja civile në operacione. Togeri i FSK-së, Albian Ajvazi, në shkollën e Adjutantëve Gjeneralë të Ushtrisë së SHBA-ve arriti rezultate të shkëlqyeshme dhe si rezultat i performancës së lartë, pas përfundimit të trajnimit, u dekorua me medaljen „Diplomatic Award” për periudhën kohore janar-korrik 2018.

FSK-ja pajiset me automjete taktike amerikane „Hamvi”

Vijon nga faqja e parë







Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në një ceremoni rasti, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe ambasadori i SHBA-ve, z. Greg Delavie, më 17.07.2018, nënshkruan aktin final të kontratës për furnizim me automjete shumë funksionale ushtarake me lëvizshmëri të lartë (HMMWV) nga Qeveria e Republikës së Kosovës me kompaninë amerikane ,,AM General” për furnizim të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, duke falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, theksoi se Forca e Sigurisë së Kosovës është një trupë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe është shembulli më i mirë i ecjes së përbashkët të Kosovës me SHBA-të dhe NATO-n: ,,Sot, ne po bëhemi dëshmitarë të një ngjarjeje të madhe për popullin e Kosovës. Forca jonë e sigurisë po modernizohet me teknikë ushtarake shumë funksionale “Hamvi”. Ngritja e kapaciteteve teknike të FSK-së dita-ditës tregon se kjo forcë po ngritët sipas standardeve të NATO-s”. Më tej, kryeministri Haradinaj theksoi: ,,SHBA-të, NATO-ja, KFOR-i dhe Bondstilli janë sinonime të qetësisë e sigurisë në Kosovë, dhe nuk është habi që populli i Kosovës është ndër popujt më pro amerikanë që i qëndron besnik miqësisë së përhershme me SHBA-të”. Në fund të fjalës së tij, i pari i Qeverisë së Kosovës, z. Haradinaj tha: ,,Kosova është rreshtuar me ushtritë e lirisë dhe të paqes. Tranzicioni i FSK-së do të bëhet në koordinim të plotë dhe me mbështetjen e aleatëve tanë strategjikë. Kosova nga një vend që absorbon siguri po kthehet në një vend që prodhon dhe ofron siguri dhe është e gatshme të marrë pjesë në misione paqeruajtëse, kudo që aleatët tanë e shohin të nevojshme”.

Ndërsa, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha tha: ,,Sot, është një ditë e veçantë për mua, Ministrinë dhe FSK-në. Mjetet taktike ,,Hamvi” do të jenë në shërbim të FSK-së, dhe ky akt i nënshkrimit është i një rëndësie të veçantë që i kontribuon thellimit të bashkëpunimit me SHBA-të, avancimit të FSK-së, si dhe rrit shkallën e ndërveprueshmërisë me shtetet e NATO-s.”. Në fund të fjalës së tij, ministri Berisha tha: ,,Dua të falënderoj Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e pakursyer në vazhdimësi e sidomos në kuadër të trajnimeve, edukimit apo edhe pajisjeve përmes Zyrës për Bashkëpunim Ushtarak (ODC) dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, dhe ky bashkëpunim do të vijojë edhe më tej në të ardhmen”.

Nga ana e tij, ambasadori amerikan, z. Greg Delavie tha se: ,,Sot po kremtojmë nënshkrimin e kontratës për furnizim ndërmjet FSK-së dhe kompanisë ,,AM General” dhe se më vjen mirë që Forca e Sigurisë së Kosovës e ka përzgjedhur Hamv-në si automjetin e ardhshëm të saj. Kjo kontratë i dërgon shenjë të qartë botës se Kosova mëton ta çojë deri në fund integrimin euroatlantik në të gjitha mënyrat. Kjo blerje do ta forcojë partneritetin ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe do të ndihmojë në përmbushjen e ndërveprueshmërisë në mes të forcave ushtarake amerikane, NATO-s dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu, jemi të ngazëllyer që jemi pjesë e kësaj ere të re të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe presim me padurim ta shohim dërgesën e parë të Hamvi-ve gjatë këtij viti”.

Kurse, nënkryetari i kompanisë ,,AM General” z. Lawrance Platt, falënderoi Qeverinë e Kosovës dhe FSK-në për besueshmërinë për furnizimin me automjetet të Kompanisë, ashtu siç ka bërë ushtria amerikane dhe shumë shtete të NATO-s. Në ceremoninë e organizuar nga Qeveria e Kosovës të pranishëm ishin edhe ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, z. Rrustem Berisha, sekretari i përgjithshëm z. Shkelzen Sylaj, komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneral major Gëzim Hazrolli, nën-presidenti ekzekutiv i kompanisë “AM Generals”, z. Lawrance Platt, komandanti i KFOR-it gjeneral major Salvatore Cuoci, komandant i Kampit Bondsteell kolonel Nick Ducich, gjeneralë të FSK-së, ministra, ambasadorë dhe atashe ushtarakë të akreditуar në Kosovë, si dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.



Ambasada Amerikane ndanë mirënjohje për ekipin e FSK-së që ofroi ndihmën e parë mjekësore të lënduarve në aksident komunikacioni



Me një ceremoni modeste në mjediset e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, mbajtur më 3 korrik 2018, atasheu ushtarak kolonel Jeffrey Fischer, në emër të ambasadorit amerikan në Kosovë, z. Greg Delavie, ndau nga një certifikatë-mirënjohje për katër ushtarakët e FSK-së, pjesë e ekipit të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave, të cilët treguan gatishmëri, vetëmohim dhe profesionalizëm në ofrimin e ndihmës së parë mjekësore për disa qytetarë të lënduar si pasojë e aksidentit në komunikacion. Me këtë rast, përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane, atasheu ushtarak, kolonel Jeffrey Fischer, në emër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke ua dorëzuar mirënjohjet për shërbim të jashtëzakonshme majorit Ali Vishit, tetarëve Arban Rushiti, Alban Shyti si dhe ushtarit Predrag Maksimoviç, në shenjë mirënjohje dhe vlerësimi për punën dhe angazhimin e tyre në aksionin e ndërmarrë me vetiniciativë, në përgjigje të situatësdhënie e ndihmës së parë në vend incident, theksoi që stafi i Ambasadës Amerikane edhe FSK-ja janë krenarë me aksionin e pjesëtarëve të FSK-së, si dhe theksoi se të gjithë këta janë duke punuar bashkë, çdo ditë e më shumë për një FSK edhe më të fuqishme dhe më profesionale. Ndërsa, gjeneral major Gëzim Hazrolli, drejtor i Drejtorisë për Operacione, në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, duke iu drejtuar të dekoruarve, e vlerësoi lartë iniciativën e kolonelit Fischer, në emër të ambasadorit, për ta vlerësuar punën dhe angazhimin e pjesëtarëve tanë. Ky akt, tha gjeneral Hazrolli është edhe një dëshmi tjetër se mbështetjen dhe përkrahjen e partnerëve tanë jemi duke e vënë në jetë konkretisht.

,,Për me qenë hero nuk duhet që patjetër me ndodhë një emergjencë me përmasa të mëdha, nuk duhet që edhe me patjetër të ndodhë luftë, heronjtë janë edhe të paqes, dhe shpëtimi i një jete është gjithmonë një akt që duhet vlerësuar’’, tha gjeneral major Gëzim Hazrolli. Me këtë rast, udhëheqësi i ekipit të FSK-së, major Ali Vishi, falënderoi Ambasadën Amerikane për vlerësimin si dhe paraqiti një ekspoze të aksionit, ku foli për gatishmërinë dhe vetëmohimin e pjesëtarëve të ekipit të tij në përgjigje të situatës së shkaktuar nga aksidenti ndërmjet veturave civile, në aksin rrugor Prishtinë–Ranillug, derisa ekipi i FSK-së ishte caktuar të marrë pjesë në takimin për siguri në Komunën e Ranillugut. Gjithashtu, major Vishi e vlerësoi lart edhe angazhimin e Ambasadës Amerikane në kujdesin dhe mbështetjen me trajnime të pjesëtarëve të FSK-së, sidomos me trajnimet mjekësore, të cilat u vunë në jetë në rastin konkret. Certifikata e mirënjohjes për katër pjesëtarët e FSK-së, të Njësisë për Reagim në Kriza, e dhuruar sot nga koloneli Fischer në emër të SHBA-ve, ka këtë motivacion: ,,Në shenjë mirënjohjeje për reagimin tuaj me vetiniciativë, në përgjigje të situatës nga aksidenti rrugor, Ju demonstruat përkushtim dhe profesionalizëm si pjesëtarë të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave. Reagimi juaj reflekton sukses për ju, FSK-në dhe Kosovën në përgjithësi’’.



Ministri Berisha dhe gjeneral Rama pritën në takim lamtumirës atasheun ushtarak shqiptar, kolonel Ahmet Leka





Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës(MFSK)z. Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 26 korrik 2018, pritën në takime të ndara atasheun ushtarak shqiptar, kolonel Ahmet Leka, me rastin e përfundimit të misionit të tij. Ministri Berisha dhe komandanti Rama falënderuan kolonelin Leka dhe përmes tij Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë për kontributin e tyre të madh në avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në shumë fusha.

Në shenjë falënderimi, ministri Berisha kolonelit Leka i dhuroi Mirënjohje për angazhimin e tij në avancimin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Më këtë rast, ministri Berisha u shpreh: "Ju falënderoj për bashkëpunimin korrekt dhe frytdhënës e mbi të gjitha vëllazëror gjatë mandatit Tuaj si Atashe i Shqipërisë në Kosovë.

Ndihma Juaj dhe e Shtetit shqiptar kanë një domethënie të veçantë për ne. Më lejoni që në emër të Ministrisë që drejtoj, në emër të FSK-së dhe në emrin tim personal, të ju falënderoj për kontributin Tuaj, në fusha të ndryshme, në Forcën e Sigurisë të Kosovës," tha ministri Berisha. Atasheu Ushtarak i Republikës së Shqipërisë, kolonel Ahmet Leka, është shprehur falënderues për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve gjatë ushtrimit të mandatit të tij në Kosovë. "Kam pasur fat dhe privilegj të punoj me Ju ministër Berisha. Jam ndier shumë i vlerësuar dhe i motivuar në detyrën time. Padyshim kjo është periudha më e mirë e karrierës time, pasi më mundësoj të kontribuoj për Ju, për vëllezërit e mi, duke realizuar kështu një ëndërr fëmijërie. Duke njohur angazhimin tuaj, potencialet dhe përpjekjet e vazhdueshme për ngritjen e vlerave të ushtarakëve të Kosovës, jam i bindur se janë garancia më e mirë për krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, përkatësisht transformimin e FSK-së në FAK", është shprehur kolonel Leka.

Oficerë dhe familjarë të Forcave të Armatosura të Turqisë vizitojnë Kosovën

Bazuar në Protokollin mbi shkëmbimin e personelit ushtarak dhe civil për qëllime sociale dhe kulturore ndërmjet Ministrisë për FSK-në dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, prej datës 26 qershor deri më 02 korrik 2018, si mysafirë të MFSK/FSK-së ka qëndruar për vizitë kulturore në vendin tonë një delegacion 10 anëtarësh nga stafi ushtarak i Forcave të Armatosura të Turqisë me bashkëshortet e tyre. Delegacioni nga Turqia është pritur edhe nga komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe gjeneral brigade Naim Haziri, si dhe nga oficerë tjerë të FSK-së, disa nga të cilët shoqëruan delegacionin gjatë tërë kohës së qëndrimit në Kosovë. Mysafirët nga Forcat e Armatosura të Turqisë kanë realizuar edhe vizita të shumta nëpër vende të ndryshme historike dhe me interes kulturor si në Kosovë, Maqedoni dhe në Shqipëri. Në Kosovë kanë vizituar Muzeun Kombëtar, Xhaminë e Madhe, Ministrinë për FSK-në, Kazermën "Adem Jashari", Sheshin "Nëna Terezë", vendqëndrimin e stafit të KFOR-it turk në "Film City", Tyrben e Sulltan Muratit, Kompleksin Memorial të Jasharajve në Prekaz, Sheshin e Pejës, tek busti i Shkelzen Haradinajt vunë buqeta lulesh dhe nderuan me minutë heshtje dhe burimin e Drinit të Bardhë në Radavc të Pejës. Po ashtu në qytetin e Prizrenit përveç shumë objekteve me rëndësi kulturore dhe historike, vizituan Muzeun Etnologjik dhe atë Arkeologjik si dhe kampin e KFOR-it turk, ku u pritën nga stafi komandues i tij. Ndërkaq, në Shkup e Tiranë ata vizituan kanionin e Matkës, kalanë e Shkupit, xhaminë e Mustafë Pashës, Pazarin e Vjetër, Sheshin e Shkupit, Bunkerin Art, Xhaminë e Ethem Beut, Bulevardin "Nënë Tereza", Sheshin "Skënderbeu", Malin e Dajtit etj. Vizita është realizuar sipas agjendës së paracaktuar dhe mysafirët u shprehën mjaft të kënaqur me mbresa të veçanta dhe shumë falënderues për pritjen.



Gjeneral Naim Haziri vizitoi operacionet e çminimit në terren



Komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri, i shoqëruar edhe nga kolonel Esercito Terebinito, këshilltar i komandantit të FSK-së, nënkolonel Paul Stainthorpe, këshilltari i komandantit të FSK-së, major Christopher Donor, atashe ushtarak i SHBA-ve, si dhe kolonel Shaip Haziri, komandant i Regjimentit të Mbrojtës Civile (RMC), më 27 korrik 2018, vizituan ekipet e deminimit të FSK-së, të cilat janë duke zhvilluar operacione çminimi në Parkun e Lirisë në Ferizaj dhe në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Gjeneral Haziri, gjatë këtyre vizitave, nga pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit, u njoh nga afër me fushëveprimin dhe ecurinë e operacioneve të çminimit në zonat e minuara. Naim Haziri i përgëzoi pjesëtarët e ekipeve të Kompanisë së Deminimit për suksesin dhe profesionalizmin që kanë treguar, pa pësuar as edhe një dëmtim gjatë punës së tyre mjaft të rrezikshme, tash e sa vite kudo që kanë vepruan në Kosovë. Ai gjithashtu i ka inkurajuar ekipet e deminimit që edhe në të ardhmen të vazhdojnë me pastrimin e tokave të minuara, për të mbrojtur kështu jetën e qytetarëve të vendit. Në fund, për mysafirët, ekipet e Kompanisë së Deminimit prezantuan pajiset e punës dhe demonstruan në praktikë punën e tyre në pastrimin e terrenit.

Oficerët e FSK-së përfundojnë Kursin e Lartë të Oficerit në Republikën e Shqipërisë



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), më 2 korrik 2018, diplomuan kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) dhe kursantet e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm(KKSHP). Në ceremoninë e diplomimit mori pjesë një delegacion i Forcë së Sigurisë së Kosovës i udhëhequr nga gjeneral brigade Naim Haziri, si dhe atasheu ushtarak, kolonel Bashkim Shillova, ndërsa nga FARSH ishte edhe gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, shef i Shtabit të FARSH. etj. Në këto kurse, për vitin akademik 2017-2018, shkollimin e vijuan gjashtë pjesëtarë të FSK-së. Kursin e Lartë të Oficerit e ka mbaruar një pjesëtar ndërsa, pesë të tjerë në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm. Pjesëtarët të cilët me sukses përfunduan këto kurse janë: Nënkolonel Bekim Zejnullahu, përfundoi (KLO) dhe ku mori mirënjohje për rezultatet e treguara gjatë këtij viti, gjithashtu edhe major Adem Shyti, mori mirënjohje për rezultatet e treguara në këtë kurs, si dhe diplomuan edhe major Adem Shyti, major Ibrahim Revuqi, major Agim Beqiri, major Astrit Halilaj dhe major Demë Lulaj.

Batalioni i Tretë i BRSH-së përfundoi trajnimin „Komando dhe Bjeshkatari”

Në ambientet e Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Mitrovicë, dje (16.07.2018) është mbajtur ceremonia e certifikimit të 20 pjesëtarëve të cilët përfunduan me sukses trajnimin ,,Komando dhe Bjeshkatari”. Ky trajnim ka filluar më 04.06.2018 dhe ka përfunduar më 13.07.2018. Ligjëruesit, mbikëqyrësit dhe vlerësuesit të këtij trajnimi ishin nga Ekipi Trajnues Turk i cili në fund u nda i kënaqur me arritjet, përgatitjen dhe disiplinën e pjesëtarëve të FSK-së, që morën pjesë në trajnim. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë pjesëtarë të Kompanisë 3A, 3B dhe 3C. Trajnimi ka zgjatur gjashtë javë - katër javë janë mbajtur në kazermën ,,Minatori” në Mitrovicë dhe dy javë në kazermën e Regjimentit të Mbështetjes



Civile ,,Evropianët e Rinjtë” në Pomozotin. Gjatë kësaj kohe të trajnimit janë realizuar ligjërata të kombinuara teorike dhe praktike në terren, të përcjella me teste me shkrim dhe ushtime praktike. Programi i trajnimit ,,Komando dhe Bjeshkatari” përfshinë temat e navigimit tokësor- ditën dhe natën; kalimin e poligonit të kalitjes; taktikat e qitjes me avancim individual në qifte, me skuadër dhe me togë; lëvizjet taktike individuale, ekip, skuadër dhe togë; repelimi nga vende kodrinore-malore dhe aktivitete sfiduese fizike, përfshirë marshime të vazhdueshme në distanca të gjata dhe vrapim me pajisje ushtarake deri në 27 km.

Në ceremoni të certifikimit, të pranishëm ishin zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Xhevahir Geci, zv. komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë kolonel Hysen Dreshaj, komandanti i Batalionit të Tretë, nënkolonel Sylejman Cakaj dhe koloneli i Ekipi Trajnues Turk Kemal Olçar. Nënkoloneli Sylejman Cakaj-komandant i Batalionit të Tretë, në adresimin e tij para të pranishmëve theksoi rëndësinë e arritjes së objektivave trajnuese të këtij trajnimi dhe njëherësh falënderoi Ekipin Trajnues Turk, për kontributin e dhënë në realizimin e këtyre objektivave. Ndërsa, zv. komandanti i Forcave Tokësore, gjenerali Xhevahir Geci, në fjalën e tij, përgëzoi komandantin e Batalionit të Tretë për të arriturat e përgjithshme dhe falënderoi Ekipin Trajnues nga Turqia për kontributin e dhënë në trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së, e në veçanti pjesëtarët e BAT-3. Ky trajnim ishte një ndër trajnimet më sfiduese që kanë zhvilluar pjesëtarët e Batalionit të Tretë si dhe trajnimi i parë i këtij lloji që është mbajtur në FSK. Trajnimi ‘Komando dhe Bjeshkatari” tregon edhe një herë se Batalioni i 3-të është i gatshëm dhe ka kapacitete që të zhvillojë operacione për t’ju dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës në zonën e tij të përgjegjësisë. Në përfundim të kësaj ceremonie u ndanë certifikata për pjesëmarrësit në trajnim dhe instruktorët turq.


Pjesëtarja e FSK-së, Gentiana Korpuzi, instruktore e fitnesit fizik në Mbretërinë e Bashkuar



Falë bashkëpunimit intensiv dhe shumë të suksesshëm ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës/ Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, pjesëtarja e FSK-së, Gentiana Korpuzi u ftua përsëri në Shkollën e Ushtrisë së Trajnimit Fizik si instruktore për një shtojcë dyvjeçare. Kjo kontratë është e para e këtij lloji për FSK-në, e cila flet për besimin që Ushtria britanike ka në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe pjesëtarët e saj, konkretisht në Gentiana Korpuzin, dhe që shërben gjithashtu për të thelluar lidhjet historike të FSK-së dhe Kosovës me Ushtrinë britanike. Pjesëtare Gentiana Korpuzi, pas shkollimit dyvjeçar parashihet që të kthehet përsëri dhe të investojë në FSK, në mënyrë që aftësitë dhe përvojën e fituar në Britani të Madhe t’i aplikojë në praktikë në FSK. Gentiana është pjesë e një gjenerate të re në FSK, e cila sjell njohuritë, aftësitë dhe përvojën nga trajnimet jashtë vendit në FSK dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në bërjen e saj më të përshtatshëm, më të shëndetshëm dhe më operative. Ajo në kohët e fundit ka organizuar dhe udhëhequr një Kurs instruktori të trajnimit fizik të FSK-së në Qendrën e Trajnimit dhe Doktrinës së FSK-së në Ferizaj. 20 të diplomuarit në Kursin për instruktorë të fitnesit fizik janë kthyer nëpër njësitë e tyre për të çuar përpara zhvillimin fizik dhe trajnimin në palestër. Gentiana Korpuzi si instruktore e fitnesit fizik gjithashtu ka udhëhequr aktivitetet fizike me rastin e përzgjedhjes së pjesëtarit të fundit të FSK-së për akademitë e Mbretërisë së Bashkuar. Pjesëtarja e FSK-së, Gentiana Korpuzi ka përfunduar për 9 muaj studimet në Shkollën e Armatës Britanike të Trajnimit Fizik duke zhvilluar teknikat dhe teorinë fizike. Ajo gjithashtu është femra e parë që mbikëqyr që ka përfunduar një nga kurset fizike më prestigjioze që ushtron Ushtria britanike.



Certifikohen pjesëtarët e FSK-së në Kursin për mbijetesë në ujëra



Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së, në Pomozatin, më 17.07.2018, është mbajtur ceremonia e certifikimit të tetë pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kanë përfunduar me sukses Kursin e parë një javor të mbijetesës në ujë të mbajtur për herë të parë në FSK. Ky kurs është zhvilluar bazuar në nevojat operacionale të nxjerra nga përvojat reale të pjesëtarëve të përfshirë në detyrat e kërkim-shpëtimit. Materiali bazë i këtij trajnimi ka qenë Broshura e trajnimit për mbijetesë në ujëra e Ushtrisë Amerikane. Instruktorët e QTKSH-së përdorën këtë broshurë dhe e kombinuan me përvojat e tyre personale nga operacionet reale të kërkim-shpëtimit në lumenjtë dhe liqenet e Kosovës, si dhe zhvilluan një planprogram mësimor specifik për mjedisin e Kosovës. Duke qenë hera e parë e mbajtjes së këtij kursi nga QT-ja, pjesëmarrës kanë qenë vetëm pjesëtarët e FSK-së të cilët janë aktualisht zhytës. Studentët janë trajnuar rreth ndihmës së parë mjekësore, si reagues të parë dhe si ta shpëtojnë dikë që gjendet në vështirësi në ujë. Ata kanë mësuar si të krijojnë pajisje lundrimi nga gjësendet që kanë përreth, si dhe kanë mësuar si të krijojnë dhe të përdorin litarët për të shpëtuar viktimat. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e uniformës, rripit apo edhe lidhëseve të këpucëve. Studentët gjithashtu kanë lundruar nëpër lumenj në një gjatësi prej 2km për të gjetur viktimat në ujë. Duke marrë parasysh se trajnimi është zhvilluar ditën dhe natën, pjesa më e vështirë ka qenë përfundimi i notit prej 1,5km në liqenin e Batllavës, duke bartur me vete kowmplet uniformën derisa mbështeteshin vetëm në një pjesë druri për të evituar fundosjen në ujë. Trajnimi për mbijetesën në ujë tani do të vlerësohet nga stafi i QT-së dhe modifikimet e nevojshme do të bëhen në të ardhmen, për të siguruar që programi të japë plotësisht atë që është e nevojshme për FSK-në që të ndihmojë në mënyrë të sigurt autoritetet civile.



Pjesëtarë të FSK-së, certifikohen për instruktorë të fitnesit fizik

Sot në mjediset e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, më 19.07.2018, u mbajt ceremonia e certifikimit të trajnimit pesë-javor për instruktorë të fitnesit fizik i cili u realizua nga instruktorët e FSK-së. Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale gjeneral brigade Naim Haziri, këshilltari i komandantit të FSK-së koloneli Sainthrope, zv. komandanti i Komandës së



Doktrinës dhe Stërvitjes koloneli Mehmet Lladrovci, shefi i Shtabit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes koloneli Gyrner Murati, përfaqësues të federatave të Kosovës, përfaqësues të Policisë së Kosovës, familjarë të kursantëve si dhe oficerë dhe pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së. Komandanti i Qendrës së Stërvitjes Specialistike, majori Ilmi Ramusholli, foli me hollësi rreth këtij trajnimi të realizua nga instruktorët e FSK-së, të cilët janë certifikuar nga Ushtria e Mbretërisë së Bashkuar. Ndërsa, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, falënderoi instruktorët dhe kursantët për angazhimin dhe përkushtimin e tyre gjatë realizimit të Kursit të fitnesit fizik, duke i marrë si shembull për disiplinën e treguar dhe rezultatet e arritura. Programi i fitnesit fizik për instruktor është përshtatur me nevojat e FSK-së dhe është duke funksionuar në mënyrë të shkëlqyeshme, falë punës së palodhshme të instruktorëve të FSK-së dhe mbështetjes së vazhdueshme të instruktorëve nga Mbretëria e Bashkuar. Kursin për instruktorë të fitnesit fizik e kanë përfunduar me sukses 20 pjesëmarrës nga të gjitha njësitë e FSK-së. Ata gjatë ceremonisë përmbyllëse demonstruan edhe disa nga njohuritë e fituara gjatë këtij kursi. Në fund u ndanë certifikata për kursantët dhe mirënjohje për më të dalluarit.

Varroset me nderime të larta ushtarake kapiteni i FSK-së, Sejdi Krasniqi



Në Landovicë të Prizrenit, 16 korrik 2018, u varros me nderime të larta ushtarake kapiten Sejdi Krasniqi, komandant i Kompanisë së Deminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, i cili të dielën, pas një sëmundje të rëndë ndërroi jetë. Për t'i dhënë lamtumirën e fundit kapiten Sejdi Krasniqit nga Ministria e FSK-së ishte sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneralmajori Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Xhevahir Geci, gjeneral brigade Naim Haziri si dhe oficerë dhe zyrtarë të lartë të FSK-së dhe MFSK-së.



Në akademinë përkujtimore ku ishin të pranishëm personalitete shtetërore, politike, ushtarake dhe qytetarë të shumtë, në emër të FSK-së, foli komandanti i Forcave Tokësore gjenerali Enver Cikaqi. Ai në fillim i shprehu ngushëllime familjes, pjesëtarëve të FSK-së, shokëve dhe kolegëve dhe më pas foli për jetën dhe veprën e kapiten Krasniqit, duke thënë nder të tjera: ,,E nderuar familje e kapiten Sejdi Krasniqit, më lejoni që në emër të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së dhe të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës të shpreh konsideratën time më të lartë për veprën e madhe dhe shumë të rëndësishme për vendin në përgjithësi dhe për institucionin e FSK-së, në veçanti të oficerit, të bashkëluftëtarit, të mikut tonë-komandant Sejdi Krasniqit. Ai rrjedhë nga një familje patriotike që i kishte dhënë vendit në periudha të ndryshme të historisë sonë shumë veprimtarë e luftëtarë. Kishte filluar aktivitetin e tij patriotik si i ri dhe duke vazhduar në etapa të ndryshme të jetës, në organizime të shumta patriotike duke kulmuar edhe me përfshirjen e tij në luftën e lavdishme të UÇK-së, përkatësisht në Brigadën 128 të Zonës Operative të Pashtrikut. Sejdi Krasniqi pas luftës vazhdoi aktivitetin e tij në ngritjen e institucionit shumë vitale duke shërbyer në Zonën e Dytë të Mbrojtjes të TMK-së. Kanë qenë me qindra aktivitete të suksesshme në të cilat ai ishte pjesë. Në vitin 2009 ai vazhdoi shërbimin në FSK, me shëmbëlltyrën e tij prej një oficeri të sprovuar e me një personalitet shumë të formësuar. U përzgjodh si një prej oficerëve të veçantë nga Komanda e Stërvitjes dhe Doktrinës për të qenë komandant i Kompanisë së Deminimit dhe komandant i Kazermës në Prizren. Si komandant i kësaj njësie, e cila është e veçantë dhe shumë operacionale e FSK-së, u bë sinonim i suksesit dhe përkushtimit profesional e njerëzor me ushtarët e tij e me qytetarët e Prizrenit, dhe në këtë mënyrë prezantoi dhe mbrojti fuqishëm vlerat e një ushtaraku model të vendit tonë". Në vazhdim të fjalës së tij, gjeneral Cikaqi foli gjerësisht për veprimtarinë, profesionalizmin, shkathtësitë drejtuese prej eprori, aktivitetet e shumta, virtytet morale dhe njerëzore të kapiten Sejdi Krasniqit. Në fund të fjalës së tij, gjeneral Cikaqi, tha se kapiten Sejdi Krasniqi ka ofruar shumë në shërbim të vendit, FSK-së, andaj sot e kujtojmë si ushtar e mbrojtës të Lirisë, mik të veçantë, humanist dhe të palodhur në shërbim të vendit tonë".



Ministri dhe Komandanti ngushllojnë familjen Krasniqi!

Ministri Rrustem Berisha në telegramin e tij, dërguar familjes Krasniqi, shkruan: "E nderuar familje Krasniqi, Me keqardhje të thellë e mora lajmin për ndarjen e parakohshme nga jeta të kapiten Sejdi Krasniqit, komandant i Njësisë së Deminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së dhe veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këto momente të dhembjes e të pikëllimit më lejoni t'jua përcjellë ngushëllimet e mia të thella, në emrin tim personal dhe në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ai, do të kujtohet përherë për kontributin e tij të madh në luftën për liri të vendit, por edhe për kontributin e jashtëzakonshëm në misionin e tij për ta bërë Kosovën një vend më të sigurt për të jetuar. Andaj, duke ruajtur kujtimin dhe respektin e përhershëm për kapiten Sejdi Krasniqin dhe mbarë familjen e respektuar, më lejoni që edhe një herë të ndaj dhimbjen me të gjithë ju".

Po ashtu para të pranishmëve u lexua edhe telegrami i ngushëllimit për familjen Krasniqi dërguar nga Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama. "E nderuara familja Krasniqi, Në pamundësi që të jem prezent në këtë ceremoni lamtumirëse për më të dashurin tuaj, ushtarin tim dhe Komandantin e Njësisë së Deminimit, ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Krasniqi. Puna dhe kontributi i kapiten Sejdi Krasniqit në të gjitha periudhat, gjatë luftës, në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe FSK janë mburrje jo vetëm për familjen por edhe farefisin. Ju si familje duhet të jeni krenarë me disiplinën, përkushtimin dhe dëshirën që kapiten Krasniqi kishte në shërbim të vendit. Në këto momente dëshiroj të përcjellë ngushëllimet e të gjithë pjesëtarëve të FSK-së, duke u zotuar që punën dhe kontributin e Kapiten Krasniqit dhe të gjeneratave të tjera do ta qojmë në fund. E nderuara familje Krasniqi, në këto momente dhembjeje, kërkoj nga ju që të gjeni forcë për t'i tejkaluar ditët e vështira. Puna vetëmohuese e kapiten Sejdi Krasniqit në drejtimin e Njësisë së Deminimit ishte shumë profesionale, dëshira e tij dhe shokëve tjerë të rënë për liri shumë shpejt do të kurorëzohen me transformimin e FSK-në në Forca të Armatosura të Kosovës. Me respektin më të thellë dhe përuljen time para punës së tij, më lejoni që edhe një herë t'ju shprehë ngushëllimet tona. Prehu në paqe dhe liri për të cilën luftove dhe veprove tërë jetën".

Ndërsa, në emër të veteranëve të luftës të Prizrenit, foli sekretari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Isa Berisha, kurse për jetën dhe veprimtarinë e kapiten Krasniqit, në emër të qytetarëve të Prizrenit, foli kryetari i Komunës Mytaher Haskuka. Në emër të familjes të gjithë të pranishmit i ka falënderuar Arbnor Sejdi Krasniqi.

Pas akademisë ceremonia është zhvendosur në Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Landovicë. Kapiten Sejdi Krasniqi, për në banesën e tij të fundit u përcoll nga Togu Ceremonial i FSK-së, pjesëtarë të Kompanisë së Deminimit, të FSK-së, kolegë të tij të shumtë dhe nga familjarë. Këtu para familjarëve, pjesëtarëve të FSK-së dhe shumë qytetarëve nga anë të ndryshme të vendit, fjalën lamtumirës e ka mbajtur kolonel Shaip Haziri, komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, i cili vlerësoi lart përkushtimin, profesionalizmin dhe bashkëpunimin e mirë me kapiten Sejdi Krasniqin gjatë shërbimit të tij në FSK.

Në emër të bashkëluftëtarëve dhe të Brigadës 128 të UÇK-së, foli Orhan Bislimi. Ndërsa në përfundim të kësaj ceremonie varrimi, në emër të familjes Krasniqi foli vajza e të kapiten Krasniqit, Xheneta Krasniqi.

FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 72 • 12 Tetor 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

Presidenti Hashim Thaçi përgëzoi FSK-në për rezultatet e arritura

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në cilësinë e Komandantit Suprem të FSK-së, më 29.09.2018, bëri një vizitë në Komandën e Forcave Tokësore në Prishtinë. Presidenti Thaçi u prit nga komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralë, oficerë madhorë, oficerë, nënoficerë, ushtarë dhe kadetë të FSK-së. Në fjalimin e tij drejtuar të pranishmëve në sallën e madhe të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së (KFT), presidenti Thaçi mbajti një fjalim, ku shprehu angazhimin e tij si President për çështje të rëndësishme të aktualitetit politik, shtetëror e ndërkombëtar. Ai foli për procesin e liberalizimit të vizave, për anëtarësimin e Kosovës në Interpol, për dialogun e Kosovës me Serbinë



dhe procesin e tranzicionit të FSK-së në ushtri. Në fjalën e tij, presidenti Thaçi ndër të tjera theksoi: "Forca e Sigurisë së Kosovës me profesionalizimin e vet është krenari e çdo qytetari të Kosovës, ju duhet të ndiheni mirë se jeni institucioni më i besuar dhe më i respektuar i qytetarëve të Kosovës, por edhe i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Me angazhimin e çdo pjesëtari të FSK-së, ajo sot është një forcë që me profesionalizmin e saj matet me çdo forcë të shteteve të NATO-s. Nuk e kam fjalën vetëm për përgatitjen profesionale dhe ushtarake, por për frymën e gjithë përfshirjes dhe tolerancës që ju keni zhvilluar. Prandaj ju përgëzoj të gjithëve, ju gjeneral Rama dhe ju gjeneralë të tjerë, eprorë, oficerë e ushtarë. FSK-ja gjithmonë në bashkëpunim me NATO-n dhe partnerët tjerë perëndimorë ka arritur në pikën ku është e gatshme që sot të marrë përgjegjësi shtesë, atë të një ushtrie të vërtetë. Procesi i transformimit të FSK-së në ushtri të Kosovës tani më përfundimisht ka hyrë në fazën e fundit, kjo nënkupton që në muajt në vijim në Kuvendin e Kosovës të miratohen tri ligje për FSK-në, në një procedurë krejt të rregullt. Ligji për mandatin e ri të FSK-së. Ligji për statusin e pjesëtarëve të FSK-së dhe Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes. Deri këtu tash e dy dekada kemi arritur në partneritet të plotë së bashku me SHBA-të dhe me NATO-n. Me këtë partneritet do të vazhdojmë deri në zyrtarizmin e Forcave të Armatosura të Kosovës, duke marrë pjesë në programet e NATO-s dhe deri në ditën kur jemi gati të jemi pjesë e Aleancës Veri-Atlantike. Prandaj si Komandant Suprem i FSK-së sot, dhe i Forcave të Armatosura të Kosovës së shpejti, e them me bindje të plotë se kjo forcë është dhe do të mbetet krenari e kombit. Forcat e Armatosur të Kosovës do të kontribuojnë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë por edhe më gjerë. Do të jetë ushtri shumetnike në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe në çdo pjesë të Republikës së Kosovës. Hapi kryesor edhe këtu është bashkimi i të gjithëve rreth një synimi rreth një vizioni".

PROJEKTLIGJET PËR TRANSFORMIMIN E MFSK/FSK-së MIRATOHEN UNANIMISHT NË QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS




Në mbledhjen e Qeverisë së Republikës të Kosovës të mbajtur më 13.09.2018, me votë unanime të kabinetit qeveritarë u miratuan tri ligjet bazë për transformim të FSK-së me mision dhe detyra shtesë: Ligji për Forcën, Ligji për Shërbim në Forcë dhe Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes. Në mbledhjen e Qeverisë së vendit, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, paraqiti ekspozenë ku argumentoi arsyeshmërinë për procedimin dhe miratimin e Pakos së Ligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Gjermania i dhuroi FSK-së 44 automjete taktike dhe pajisje të tjera përcjellëse

Komandanti i Forcë së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shefi i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe Forcën (NALT), gjeneral brigade Uwe Becker, më 26.09.2018, solemnisht bënë dorëzim-pranimin e donacionit prej 44 automjeteve taktike dhe 77 kompleteve me pajisje speciale, që Forcat e Armatosura të Gjermanisë i kanë dhuruar FSK-së.

vazhdon në faqen pesë

Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Italisë



Në mjediset e Qeverisë të Republikës së Kosovës, më 18.09.2018, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtës të Republikës së Italisë. Në aktin solemn, të pranishëm ishin kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rraham Rama, ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Italisë, Elisabetta Trena, gjenerali Grasiano dhe ambasadori i Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi.

Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Italisë parasheh bashkëpunimin e dyanshëm në fushën e trajnimeve, arsimimit dhe edukimit, shkëmbimit të përvojave në rrugën e integrimeve euroatlantike etj.

Ministren e Mbrojtjes të Italisë, znj. Elisabetta Trena së bashku me delegacionin që ajo udhëhiqte, i priti kryeministri Haradinaj. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe ministri i FSK-së z. Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe zv.ministri Burim Ramadani.

Me këtë rast, kryeministri Haradinaj e njoftoi ministren Trenta për zhvillimet e fundit politike në vend, përmirësimin e situatës së sigurisë, ndërtimin e raporteve të mira me fqinjët dhe të arriturat e Kosovës në ndërtimin e sistemit të sundimit të rendit dhe ligjit. Gjithashtu kryeministri Haradinaj shprehu përkushtimin për bashkëpunim të mëtejmë me Italinë, duke kërkuar mbështetjen e ministres Trenta në proceset e rëndësishme për vendin, me theks të veçantë për tranzicionin e FSK-së në ushtri të Kosovës.

Ndërsa, nga ana e saj, ministrja e Mbrojtjes e Italisë, Elisabetta Trenta, vlerësoi të arriturat në të gjitha fushat me rëndësi për vendin, duke theksuar përkrahjen e mëtejme të Italisë në proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Kryeministri Haradinaj, po ashtu mori pjesë edhe në nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Forcës të Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Italisë.

Shefi i Shtabit të FA të Italisë, gjenerali Farina pritet me ceremoni ushtarake në FSK

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, (05.09.2018) me ceremoni ushtarake priti, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Italisë, gjenerallejtënant Salvatore Farina. Ministri Rrustem Berisha, gjeneral Rama, zëvendësministrat Burim Ramadani dhe Agim Çeku, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj dhe stafi i lartë i MFSK/FSK-së zhvilluan një takim të përbashkët me delegacionin italian të Forcave të Armatosura, ku përpos kryesuesit të delegacionit, gjeneralit Farina ishin edhe komandanti i KFOR-it, gjenerali Salvatore Cuoci dhe ambasadori i Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi.



Me këtë rast, ministri Berisha falënderoi gjeneralin Farina, për angazhimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen e pakursyer të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Italisë dhënë Kosovës, popullit, sigurisë dhe lirisë së saj. Ministri Berisha, theksoi se falë mbështetjes së shteteve dhe forcave mike dhe partnere, FSK-ja ka arritur të zhvillohet profesionalisht, të jetë forcë e përfaqësuar nga të gjithë dhe në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës. Më tej, ministri Berisha duke i shprehur gjeneralit italian Farina, gatishmërinë për bashkëpunim shprehu interesimin dhe synimin që Ministria për FSK-në dhe Ministria e Mbrojtjes së Italisë, sa më parë të formatojnë bashkëpunimin me marrëveshje ndërshtetërore. "Objektivi i Kosovës është anëtarësimi në NATO, integrimi në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në iniciativa rajonale të mbrojtjes. Republika e Kosovës është e vetëdijshme për sfidat rajonale dhe globale. Si FSK jemi të gatshëm që me disa prej kapaciteteve tona të kontribuojmë për paqe së bashku me partnerët tanë kudo ku paraqitet nevoja për të kontribuar për paqen dhe stabilitetin e vendit tonë".


Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha: "FSK-ja është ngritur dhe zhvilluar në saje të bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të partnerëve dhe miqve të Kosovës. Ne na duhet edhe më tutje kjo mbështetje. Jemi në një fushatë intensive informuese dhe këshilluese me shtetet dhe qendrat e rëndësishme evropiane, për procesin e zhvillimit dhe të ardhmen e FSK-së. Udhëheqësit janë për të marrë vendime të vështira, por ne duam që këto vendime mos ta befasojnë askënd".

Kryesuesi i delegacionit italian, gjenerallejtënant Salvatore Farina, në fjalën e tij, tha se Forcat e Armatosura të Italisë janë të gatshme që në vazhdimësi ta mbështesin Kosovën në sferën e sigurisë dhe zhvillimit të kapaciteteve të saj të sigurisë. Ai, FSK-në e vlerësoi si faktor të rëndësishëm dhe pjesë të zgjidhjes së problemit. Në fund, gjeneral Farina premtoi jo vetëm arritjen dhe zyrtarizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit por edhe hapjen e dyerve për prosperitetin e FSK-së në të ardhmen

Ministri Rrustem Berisha panelist në Konferencën e pestë të ambasadorëve të Kosovës

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, e ka mbajtur fjalën kryesore në panelin e dytë të Konferencës së pestë të ambasadorëve, me temë: „Siguria dhe mbrojtja në dhjetëvjetëshin e dytë të shtetësisë së Republikës së Kosovës" e cila është mbajtur në Prishtinë. Pjesë e panelit të dytë në Konferencën "Siguria dhe mbrojtja në dhjetëvjetëshin e dytë të shtetësisë së Republikës së Kosovës, ishin edhe ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Për sfidat e brendshme dhe rajonale të sigurisë, transformimin e FSK-së dhe NATO-n, për politikën e jashtme, para ekspertëve të jashtëm, anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ministrave, përfaqësuesve të shoqërisë civile, ambasadorëve të Republikës së Kosovës të akreditуar në shtete të ndryshme si dhe korit diplomatik të ambasadave të akredituara në vendin tonë, foli ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zoti Rrustem Berisha. Ministri Berisha, pasi përshëndeti pjesëmarrësit në konferencë iu drejtuar të pranishmëve: „Me lejoni që fjalimin tim ta filloj me një frazë të huazuar nga portali i Qeverisë të Republikës së Kosovës, që në një farë mënyre paraqet edhe definicionin për siguri dhe mbrojtje. "Krahas boshteve tjerë kryesorë të ekzistencës së një shteti, siguria e brendshme dhe e jashtme, e përfituar nëpërmjet qëndrueshmërisë, stabilitetit dhe profesionalizmit të institucioneve të specializuara, mbetet "shtylla kurrizore" e ekzistencës fizike, si dhe garantimit të kushtetutshmërisë dhe funksionimit të institucioneve demokratike për çdo vend sovran. Siguria dhe mbrojtja janë prioritet dhe synim kryesor.



Bota po ndryshon me shpejtësi rreth nesh dhe ne duhet të merremi me sfida të reja çdo ditë. Që të mund të diskutojmë për sigurinë dhe mbrojtjen në dhjetëvjeçarin e ardhshëm janë një varg çështjesh, pyetjesh dhe analizash që duhet bërë për dhjetëvjeçarin e kaluar në kontest të mjedisit të sigurisë rajonale, globale e trans-nacionale. Republika e Kosovës është e rrethuar me fqinjë që tanimë janë anëtarë të NATO-s dhe të BE-së, e po ashtu edhe me fqinjë të tjerë të cilët në dokumentet e tyre strategjike kanë shprehur interesim dhe gatishmëri që të anëtarësohen në këto struktura. Gjithashtu prezenca e NATO-s (që përmes mekanizmave të saj (KFOR) është përgjegjëse për siguri në Republikën e Kosovës), BE-së dhe organizmave të tjerë jo vetëm në Republikën e Kosovës po edhe në rajon vazhdon të mbetet një faktor i ndërtimit të një paqeje të qëndrueshme rajonale", përfundoi fjalën e tij, ministri Berisha në Konferencën e pestë të ambasadorëve të Republikës së Kosovës.

Delegacioni i MFSK-së takohet me ushtarakë të NATO-s, në Bruksel



Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, të cilët shoqëroheshin edhe nga koloneli Jeton Dreshaj, qëndruan për vizitë zyrtare në selinë qendrore të NATO-s, në Bruksel. Në kuadër të fushatës, që Ministria për FSK-në ka ndërmarrë për të informuar nga dora e parë shtetet partnere dhe partnerët strategjikë, delegacioni i MFSK-së zhvilloi takime në selinë e NATO-s në Bruksel, ku diskutoi mbi tranzicionin e FSK-së, planin dhe gatishmërinë e Kosovës, që me kapacitetet e saj operacionale, specialistike të kontribuojë në të ardhmen për paqen dhe sigurinë rajonale dhe atë globale.

Në fillim, zëvendësministri Ramadani dhe gjeneral Rama si dhe delegacioni i MFSK-së zhvilluan takime të ndara me stafin ndërkombëtar të kryesuar nga asistenti i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Dr. John Manza. Gjithashtu, delegacioni i MFSK-së, në krye me zëvendësministrin Ramadani, zhvilloi takime edhe me përfaqësuesit e shteteve të NATO-s, si: SHBA-ve, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe një takim të veçantë me përfaqësuesin e Greqisë në NATO. Gjatë qëndrimit në selinë e NATO-s, delegacioni i MFSK-së pati takime edhe me përfaqësuesit e shteteve të rajonit, si Sllovenisë, Kroacisë, Malit të Zi, Shqipërisë, Maqedonisë, Bullgarisë, Turqisë dhe të Hungarisë. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës gjatë këtij viti ka ndërmarrë një fushatë informuese në shumë prej kryeqyteteve evropiane, për të informuar për procesin e tranzicionit të FSK-së dhe planet për të ardhmen e Forcës së Kosovës, me qëllim që të informohen partnerët strategjikë, shtetet tjera partnere të NATO-s, si dhe shtetet evropiane; për gatishmërinë dhe transparencën e plotë mbi këtë proces dhe koordinimin e vazhdueshëm për një ecje përpara së bashku me partnerët tanë, në kuadër të qëllimit kryesor të deklaruar të vendit tonë, për anëtarësim në NATO dhe integrim në Bashkimin Evropian.

Gjenerali Hoffmann nderohet me medalje nga Ministri dhe Komandanti i FSK-së





Në ceremoninë e ndërrimit të drejtorit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), për MFSK/FSK-në, (28.08.2018) nga gjeneral brigade Ralf Hoffmann tek pasuesi i tij, gjeneral brigade Uwe Becker, e ku ishin të pranishëm kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj, zv. kryeministri Enver Hoxhaj, ministri Rrustem Berisha, zv. ministri Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj, komandanti i KFOR-it, gjenerali Salvatore Cuoci, zonja Liliane Maes nga Divizioni i Operacioneve në NATO, gjeneralë të FSK-së, ushtarak të KFOR-it si dhe ambasadorë e atashe të akreditуar në Republikën e Kosovës. Ministri Berisha e ka dekoruar gjeneralin Hoffman me medaljen për ‚Shërbim të Shquar; me motivacionin për bashkëpunimin e shkëlqyer në mes të MFSK/FSK dhe Ekipit të NALT. Ministri Berisha duke iu drejtuar gjeneralit Ralf Hoffman, tha: ,,Angazhimi juaj gjeneral meriton mirënjohje të lartë institucionale dhe personale për gjithë atë që ke bërë për FSK-në. Si rezultat i këtij bashkëpunimi ndërveprues FSK-ja për gjatë nëntë viteve ka arritur një shkallë të lartë të cilësisë së kapaciteteve dhe aftësive operacionale, me asistencë teknike profesionale nga ekspertet e NATO-s përmes ekipeve trajnuese, këshillëdhënëse dhe ndërlidhëse". Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama shprehu konsideratë të lartë për punën e Ekipit të NALT-it si dhe gjeneralit Hoffman. „Ne jemi shumë me fat që kemi Ekipin e NATO-s këtu dhe që punojmë së bashku në baza ditore, që na ndihmon ne për të arritur dhe qëllimet shtetërore që të jemi pjesë e sigurisë kolektive në të ardhmen e afërt. Gjeneral Rama në emër të FSK-së, i ndau medaljen ,,Shërbimi vetëmohues" gjeneralit Ralf Hoffman, në shenjë falënderimi për bashkëpunimin dhe koordinimin e vazhdueshëm gjatë shërbimit të tij në krye të NALT-it. Gjenerali Ralf Hoffmann, me rastin e pranimit të dekoratave falënderoi lidershipin e FSK-së; ministrin Berisha dhe gjeneral Ramën, për bashkëpunimin e shkëlqyer!.

FSK-ja në shenjë nderimi përkujtoi 11 shtatorin e sulmeve terroriste në SHBA



Në të gjitha kazermat e Forcës së Sigurisë të Kosovës u përkujtua 17-vjetori i sulmeve terroriste në Nju Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për të nderuar viktimat e sulmit terrorist të 11 shtatorit të vitit 2001, të ndodhur në kullat binjake në Nju Jork, ku humbën jetën mijëra civilë të pafajshëm, të gjitha njësitet e FSK-së, partnerët tanë amerikanë, oficerë dhe nënoficerë nderuan me një minutë heshtje viktimat e ngjarjes më tragjike që njeh historia ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në kazermën ,,Adem Jashari" komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, me këtë rast theksoi, se tash më është bërë tradicionale në Forcën e Sigurisë së Kosovës të bëjmë homazhe si shenjë përkujtimi në përkrahje të familjeve të viktimave dhe popullit amerikanë. „Me këtë ngjarje është sulmuar demokracia jo vetëm në Amerikë, po në gjithë botën. Jemi këtu, së bashku për të përkujtuar dhe për të nderuar Shtetin tonë aleatë, që gjatë gjithë historisë ishte në përkrahje të popullit të Kosovës dhe në veçanti gjatë viteve më të vështira të luftës 1998-1999, dhe po vazhdon të ndihmojë në ngritjen e shtetit të Kosovës, në ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe demokracisë kudo në botë", - tha në fund të fjalës së tij përkujtimore, komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi.

Gjeneral Cikaqi e kreu "Kursin e Lartë Ndërkombëtar të Mbrojtjes" në SHBA

Komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, ka përfunduar me sukses ,,Kursin e Lartë Ndërkombëtar për Menaxhimin e Mbrojtjes" në Institutin për Menaxhimin e Burimeve të Mbrojtjes në Monteral, Kaliforni, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ky kurs, i sponsorizuar dhe mbikëqyrur nga Sekretari i Mbrojtjes, mbahet një herë në vit dhe është hera e dytë që i ofrohet Forcës së Sigurisë të Kosovës. "Kursi i Lartë Ndërkombëtar për Menaxhimin e Mbrojtjes" është i mirëseardhur për vendin tonë në përgjithësi dhe në veçanti për FSK-në, ngase do të ndihmojë në shfrytëzimin sa më mirë të burimeve në procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës, dhe në përgjithësi në avancimin e sistemit të sigurisë dhe të mbrojtës në Republikën e Kosovës. Në këtë kurs, kanë marrë pjesë ushtarakë dhe civilë nga 30 shtete të ndryshme të botës, kanë ligjëruar profile të larta të Departamentit të Mbrojtjes, duke ofruar përvojat më të mira që përdorën në sistemin amerikan të menaxhimit të resurseve të mbrojtjes dhe procesit të vendimmarrjes ushtarake. Ky Institut përfshin programin e edukimit profesional të oficerëve me gradën gjeneral brigade e më lartë, në aspektin e analizimit të vendimmarrjes ushtarake si dhe në çështje të analizave të menaxhimit të burimeve të mbrojtjes.

Gjeneral Hazrolli dhe delegacioni i MFSK-së qëndruan për vizitë zyrtare në Ajova

Gjeneralmajori Gëzim Hazrolli, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Zymer Halimi, këshilltar i Presidentit të Republikës së Kosovës, me ftesë të komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajorit Timothy Orr, më 24 gusht 2018, qëndruan për vizitë zyrtare në Ajova, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në takimet e përbashkëta që zhvilluan gjeneral Gëzim Hazrolli dhe gjeneral Zymer Halimi me gjeneralët amerikanë, Timothy Orr dhe Donahade Newton, u bisedua për bashkëpunimin e mirë ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Ajovës, përkatësisht dy forcave, FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Ky bashkëpunim dypalësh zhvillohet në kuadër të marrëveshjes ndërshtetërore që ka Kosova me Ajovën, i cili me sukses po konkretizohet çdo vit me plan vjetor të aktiviteteve. Qëllimi i vizitë së delegacionit të lartë të oficerëve nga Kosova ishte kryesisht vizita në Institutin Rajonal të Trajnimeve në kampin ,,Dodge'' të Ajovës, ndjekja nga afër e mobilizimit në Shtabin e Gardës së Ajovës, vëzhgimi i trajnimeve mjekësore, mirëmbajtja e automjeteve dhe armëve, njohja me vizionin e Bazës Ajrore etj. Gjeneralët Hazrolli dhe Halimi si dhe gjeneralët amerikanë Orr dhe Newton diskutuan edhe për mundësitë e rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe vazhdimin e identifikimit të fushave të tjera për bashkëpunim në të ardhmen, me interes për avancimin e FSK-së.

Dhanë betimin gjenerata e re e kadetëve të FSK-së

Në një ceremoni zyrtare, më 28.09.2018, në kazermën ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së në Prishtinë, kadetët e rinj, që do të studiojnë në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, dhanë betimin e kadetit. Në këtë ditë të veçantë të kadetëve të gjeneratës 2022, ishin të pranishëm ministri i FSK-së Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFT-së gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në gjeneral brigade Uwe Becker, gjeneralë e oficerë të tjerë të FSK-së si dhe atashe e oficerë ndërkombëtarë. Pas rreshtimit dhe intonimit të himnit shtetëror, komandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu pranoi raportin nga komandanti i Qendrës për Studime Universitare major Vegim Kelani, dhe të dy së bashku bënë revistën para kadetëve të 4 gjeneratave. Në fjalën e tij të mbajtur me këtë rast, ministri Berisha i përgëzoi kadetë e rinj për fillimin e vitit akademik dhe i uroi ata për betimin e kadetit. Ministri vlerësoi lart përzgjedhjen e tyre për t'i shërbyer vendit, duke ju thënë se ju do të kultivoni dhe do të ngrini edhe më lart vlerat e lirisë së vendit tonë. ,,Sot, në këtë ditë të veçantë për FSK-në, për kadetët e gjeneratës 2022 dhe familjet e tyre, ju përgëzoj ju kadetë për përballimin e sfidave dhe për përzgjedhjen tuaj për të studiuar dhe për të shërbyer në FSK. Vendimi juaj për t'u bërë pjesë e FSK-së është një vendim i drejtë sepse nuk ka mision më të shenjtë se sa t'i shërbejmë dhe të kontribuojmë për vlerat e lirisë dhe për sigurinë e vendit tonë". Nga ana e tij, komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, foli për sistemin e shkollimit dhe përgatitjen e oficerëve të FSK-së, të cilët po shkollohen në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, si dhe për kualitetet që ata po bartin në detyrë gjatë shërbimit. Gjithashtu, ai vlerësoi lart edhe përgatitjen akademike të kadetëve në Universitetin Amerikan në Kosovë. Të dyja këto qendra studimi, u shpreh ai, kanë bërë që oficerët e rinj të FSK-së, kudo në shkollime dhe trajnime jashtë vendit të jenë të dalluar. Në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, këtë vit me konkurs të hapur janë përzgjedhur 16 kadetë, prej tyre dy kadetë të gjinisë femërore dhe një kadet nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama në përmbylljen e ushtrimit fushor,, Albanian Lion 18"

Në Tiranë u mbajt Dita e Vizitorëve, me rastin e përfundimit të operacionit të përbashkët të ushtrimit fushor ,,Albanian Lion 2018'', në të cilën mori pjesë edhe një delegacion i FSK-së, në krye me komandantin e saj, gjenerallejtënant Rrahman Rama, si dhe oficerë të lartë nga shtetet pjesëmarrëse në këtë ushtrim. Para rreshtave të ushtarakëve të shteteve të NATO-s, si: Shqipëria, Kroacia dhe Mbretëria e Bashkuar, ishin edhe ushtarakët e Republikës së Kosovës si shtet pjesëmarrës në ushtrim, që ka për qëllim anëtarësimin në NATO, foli ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, zonja Olta Xhaçka, e cila e çmoi lart ndërveprueshmërinë ndërmjet kontingjenteve ushtarake të vendeve pjesëmarrëse.

Ndërkaq, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, i shoqëruar nga gjenerali Fadil Hadergjonaj, komandanti i BRSH-së, përgëzoi pjesëtarët e kontingjentit të FSK-së, pjesëmarrës në ushtrimin ndërkombëtar ,,Albanian Lion 18'', për disiplinën, përkushtimin dhe profesionalizmin që ata treguan gjatë operacioneve në këtë ushtrim fushor.

Republikën e Kosovës, përkatësisht Forcën e saj të Sigurisë, në këtë ushtrim e ka përfaqësuar një kontingjent i përbërë nga 35 pjesëtarë të Brigadës për Reagim të Shpejtë.

Ushtrimi ndërkombëtar ,,Albanian Lion 18" kishte si qëllim demonstrimin dhe avancimin e shkathtësive luftarake në nivel togu dhe mbështetjen mjekësore fushore me qëllim të vendosjes së ndërveprueshmërisë taktike me partnerët strategjikë. Objektiva të këtij ushtrimi ishin: Integrimi i forcave dhe rritja e ndërveprueshmërisë taktike me partnerët, ngritja e shkathtësive manovruese individuale dhe në qifte, rritja e aftësive të mbijetesës në fushëbetejë, ngritja e njohurive për drillet e betejës në nivel skuadre dhe togu, ngritja e njohurive për operacionet e bazave patrulluese etj. Vlen të ceket se të gjitha këto aktivitete janë zhvillua në bashkëpunim me instruktorët e Trupave Komando të Marinës së Mbretërisë së Bashkuar. Ushtrimi ndërkombëtar ,,Albanian Lion 2018'', i zhvilluar në Republikën e Shqipërisë, ka filluar më 14 shtator dhe ka përfunduar më 24 shtator 2018.



Oficeri i FSK-së më i miri në Kursin e Karrierës për Kapiten të Logjistikës në SHBA



Kapiteni i FSK-së, Fatmir Lami, pjesëtar i Batalionit të Logjistikës në BMO-së, ka marrë pjesë, nga data 28 shkurt 2018 e deri më 14 shtator 2018, në Kursin e Karrierës për Kapiten për Logjistikë (LOGC3) 18-004 në Universitetin Ushtarak të Logjistikës (Army Logistics University) në Fort Lee, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këtë kurs kanë marrë pjesë oficerë të ushtrive nga Kosova, Japonia, Egjipti, Brazili, Greqia, Jordania, Turqia, Arabia Saudite, Estonia dhe Letonia. Në mesin e përfaqësuesve të këtyre vendeve, kapiteni i FSK-së, Fatmir Lami shpallet oficeri më i mirë ndërkombëtar në mesin e 13 oficerëve pjesëmarrës nga këto shtete të botës, ndërsa në nivel të përgjithshëm prej 119 pjesëmarrësve, Fatmiri zuri vendin e shtatë.

Edhe ky sukses tregon se pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës janë shumë të përkushtuar dhe me motivim të lartë. Kudo ku ata po marrin pjesë, si në trajnime apo stërvitje ushtarake nëpër universitete ushtarake jashtë vendit, po tregohen më të mirët, qoftë në gara individuale, qoftë në ato kolektive. Kapiteni Fatmir Lami ka diplomuar më 12 shtator në Universitetin Ushtarak për Logjistikë në Fort Lee, SHBA. Ai u shpreh se është i gatshëm që përvojën e fituar në SHBA ta zbatojë në praktikë në Logjistikën e FSK-së.

Gjermania i dhuroi FSK-së 44 automjete taktike dhe pajisje të tjera përcjellëse

Komandanti i Forcë së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shefi i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe Forcën (NALT), gjeneral brigade Uwe Becker, më 26.09.2018, solemnisht bënë dorëzim-pranimin e donacionit prej 44 automjeteve taktike dhe 77 kompleteve me pajisje speciale, që Forcat e Armatosura të Gjermanisë i kanë dhuruar FSK-së.

vijon në ballina

Nënshkrimit të dy gjeneralëve i ka paraprirë nënshkrimi i aktit zyrtar të pranim-dorëzimit të donacionit, të cilin në emër të MFSK-në e nënshkroi Sekretari i përgjithshëm dr. Shkelzen Sylaj dhe në emër të Kontingjentit gjerman të KFOR-it, nënkoloneli dr. Eric Offermann.

Në ceremoni morën pjesë edhe zv. kryeministri Enver Hoxhaj, ministri Rrustem Berisha, komandanti i KFOR-it gjenerali Salvatore Cuoci, ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, Christian Heldt, zv. ministri Agim Çeku, komandanti i Forcave Tokësore gjenerali Enver Cikaqi, si dhe gjeneralë e oficerë të FSK-së, KFOR-it, Kontingjentit gjerman të KFOR-it dhe mysafirë të tjerë. Me këtë rast, ministri Rrustem Berisha tha: ,,Sot është një ditë e veçantë për FSK-në, sepse donacioni prej 44 automjeteve ushtarake, do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së. Ministri Berisha, në emër të Ministrisë së FSK-së falënderoj shtetin gjerman dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë për mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së, sidomos në zhvillimin e saj me trajnime, stërvitjet dhe donacione. Shteti gjerman në vazhdimësi e ka mbështetur FSK-në dhe Republikën e Kosovës në aspektin politik, ekonomik dhe atë të sigurisë". Ndërsa, Komandanti i FSK-së, u shpreh falënderues ndaj mbështetjes së vazhdueshme që Forcat e Armatosura të Gjermanisë kanë ofruar dhe po vazhdojnë të ofrojnë për FSK-në në shumë fusha: ,,Falënderoj Kontingjentin gjerman, Ministrinë e Mbrojtjes dhe popullin gjerman për këtë donacion, i cili është shumë i rëndësishëm për FSK-në. Ishte Gjermania ajo, që në fillimin të ngritjes së FSK-së në vitin 2009 e ndihmoi FSK-në me 204 automjete taktike, pajisje mjekësore, pjesë rezervë etj., Falë kësaj mbështetjeje FSK-ja arriti atë vit kapacitetet e para operacionale. Tani, po nga Gjermania vjen edhe një donacion tjetër, 44 automjete taktike dhe pajisje përcjellëse". Nga ana e tij, ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, z. Christian Heldt vuri theksin tek marrëdhëniet e mira ndërmjet Ushtrisë së Gjermanisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe me këtë rast u shpreh: ,,Marrëdhënie të shkëlqyera në mes të Ushtrisë gjermane dhe FSK-së. Çdo herë automjetet e Gjermanisë nëpër rrugët e Kosovës do të jenë simbol i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë gjermane dhe ndërmjet dy shteteve tona. Bashkëpunimit ndërmjet nesh po evoluon dhe ka qëllim mbështetjen e Kosovës në rrugën e saj drejt integrimeve euroatlantike. Ndërsa, shefi i NALT-it, oficeri i lartë gjerman, gjeneral brigade Uwe Becker tha se, ndihet i privilegjuar që në emër të Ministrisë së Mbrojtjes po ia dhuron këto automjete FSK-së. Në fund gjenerali Becker u shpreh; ,,Këto automjete do t'u takojnë juve si mbrojtës të popullit të Kosovës. Siguria në Kosovë po bartet çdo ditë e më shumë tek autoritetet kosovare që do të jenë të vetmit dhe kryesorët për sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë, jo vetëm në letër por edhe në praktikë''. Në fund të ceremonisë, 44 ushtarë të FSK-së i vunë në lëvizje 44 automjetet, që tani e tutje do të drejtohen nga ta, për nevojat e FSK-së.







FSK-ja në Simpoziumin për ndërveprueshmëri logjistike në Gjermani

Major Bekim Haliti, shefi i Sektorit të Logjistikës në Batalionin e Logjistikës në kuadër të Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së, mori pjesë në ,,Simpoziumin për ndërveprueshmëri logjistike 2018'' i cili u mbajt në Shkollën e NATO-s, në Oberammergau të Gjermanisë. Sipas agjendës, pjesë e panelit të diskutimit ishte edhe majori i FSK-së, Bekim Haliti. Adresimi i panelit për pjesëmarrësit ishte në temën: ,,Integrimi i funksioneve logjistike-praktikat më të mira". Mbi këtë temë anëtarët e panelit kanë bërë prezantimin duke ju adresuar disa pyetjeve të cilat janë përgatitur nga organizatorët. Në koordinim me moderatorin e panelit, major Haliti ka prezantuar temën: sfidat, masat për tejkalimin e sfidave dhe bashkëpunimet e FSK-së me partnerët në fushën e logjistikës. Pjesë e këtij simpoziumi kanë qenë edhe Sesionet dypalëshe, ku majori Bekim Haliti, ka mbajtur takim me përfaqësuesit e Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, konkretisht J4 dhe J7. Bazuar në raportet e pjesëmarrësve në LIS 2014 dhe LIS 2016 si dhe diskutimet me Departamentin për Bashkëpunim e Siguri të MFSK-së dhe Departamentin e Logjistikës në MFSK, major Haliti, ka ngritur dhe adresuar disa prej temave me interes për logjistikën e FSK-së dhe avancimin e saj, në drejtim të arritjes së ndërveprueshmërisë me shtetet partnere në të ardhmen. Qëllimi i simpoziumit ishte bashkimi i aleatëve dhe vendeve partnere për të shqyrtuar dhe diskutuar mënyrat e shumta në të cilat mund të përmirësohet ndërveprimi logjistik dhe të përmirësojë sigurinë e individuale të secilit komb si dhe sigurinë e përgjithshme kolektive. Për të tretin vit me radhë, FSK-ja përfaqësohet në Simpoziumin vjetor për ndërveprueshmëri logjistike që mbahet në shkollën e NATO-s në Oberammergau të Gjermanisë.



Një delegacion i BCU-së nga Holanda vizitoi FSK-në



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës, nga data 11-13.09.2018, qëndroi një delegacion nga Qendra e Ekselencës së CIMIC-ut të Holandës dhe të CIMIC-ut të NATO-s, ku u pritën nga Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i MFSK-së, dhe në bashkëpunim me CIMIC-un e KFOR-it dhe NALT-in. Qëllimi i vizitës kishte karakter njohjen e dyanshme, me punët, aktivitetet, përparësitë, mangësitë si dhe identifikimin e nevojave për trajnime të stafit të CIMIC-ut të MFSK/FSK-së. Delegacionin nga Qendra e Ekselencës e udhëhiqte nënkoloneli Paul Sai, kapiteni Normen Schneider, shefi i CIMIC-ut të NATO-s Rusanen Timo si dhe këshilltarët e NALT-it James Grimaldi dhe Vito Samarelli. Delegacioni u prit nga Hajrush Kurtaj, drejtor i DB-CU-së në MFSK, i cili pasi e falënderoi delegacionin e CIMIC-ut për bashkëpunim e afruar, i njoftoi edhe me aktivitetet dhe detyrat e CIMIC-ut të MFSK/FSK-së. Ndërsa, zyrtari i BCU-së Agron Durmishi i njohu me misionin, detyrat, organizimin e BCU-së, strukturën, projektet, mbështetjet si dhe bashkëpunimet që BCU e MFSK-së ka me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Delegacioni nga Qendra e Ekselencës, gjithashtu u prit në vizita të ndara edhe nga gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe nga Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane në Ministrinë për FSK-në, të cilët i informuan mysafirët me aktivitetet e MFSK/FSK-së dhe njëherësh biseduan për thellimin e bashkëpunimit dhe kërkuan nga ta realizimin e trajnimeve të pjesëtarëve të BCU-së në Qendrën e Ekselencës në Holandë. Për dy ditë radhazi delegacioni i Qendrës së Ekselencës nga Holanda dhe NATO-ja, kanë realizuar vizita pune në të gjitha njësitet e CIMIC-ut në MFSK/KFT dhe në Njësinë për Reagim në Kriza, ku gjithashtu janë bërë dy prezantime lidhur me misionin detyrat dhe angazhimet e tyre karshi përmbushjes së misionit të FSK-së. Gjatë takimeve janë shkëmbyer mendime dhe ide lidhur me funksionimin e BCU-së të FSK-së, duke identifikuar në të njëjtën kohë, nevojat e shtrirjes së BCU-së edhe në njësitet tjera të FSK-së. Janë prezantuar gjithashtu Doktrina e BCU-së, Teknikat, Taktikat dhe Proceduarat e BCU-së, si dhe Politika e BCU-së, dokumente këto të sapo miratuara nga organet e NATO-s.

Ndërsa, kapiteni i Qendrës së Ekselencës, ka raportuar lidhur me të gjeturat, propozimet rreth hartimit të dokumentacionit të BCU-së, ka dhënë ide rreth shtrirjes së BCU-së edhe në nivelet më të ulëta të FSK-së, si dhe për krijimin e mundësive të pjesëtarëve të BCU-së që të trajnohen në Qendrën e Ekselencës në Holandë.

FSK-ja dhe Ambasada e SHBA-ve ndajnë pajisje mësimore për nxënësit e dy shkollave fillore

Forca e Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me Elementin Mbështetës Civilo-Ushtarak (EMCU) pranë Ambasadës amerikane në Kosovë kanë ndarë, donacion pajisje shkollore për nxënësit e shkollës fillore "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë-Lipjan dhe të shkollës fillore "Vesel Muja" në Ponesh - Gjilan. Ky donacion është koordinuar nga EMCU (Ambasada Amerikane) dhe FSK-ja, si dhe është bërë i mundur nga fondet e mbledhura nga OJQ-ja "Spirt of America". Përfitues të këtij fondi, kanë qenë 54 nxënës shqiptarë, kroat dhe të komunitetit RAE të shkollës fillore "Shtjefën Gjeçovi" si dhe 30 nxënës të shkollës fillore "Vesel Muja". Përmes këtyre projekteve dhe falë bashkëpunimit të mirë që ka FSK-ja me Ambasadën e SHBA-ve në



Kosovë, më saktësisht me EMCU-në, po realizohen projekte në ndihmë të qytetarëve të Kosovës, pa dallime etnie. Ky donacion, tash me fillimin e vitit të ri shkollorë, do të jetë një ndihmesë e madhe për nxënësit dhe familjet të cilat kanë një jetë të vështirë materiale.

FSK-ja mbështet qytetarët e Komunës së Suharekës pas vërshimeve

Forca e Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me Elementin Mbështetës Civilo-Ushtarak (EMCU) pranë Ambasadës amerikane në Kosovë kanë ndarë, donacion pajisje shkollore për nxënësit e shkollës fillore "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë-Lipjan dhe të shkollës fillore "Vesel Muja" në Ponesh - Gjilan. Ky donacion është koordinuar nga EMCU (Ambasada Amerikane) dhe FSK-ja, si dhe është bërë i mundur nga fondet e mbledhura nga OJQ-ja "Spirt of America". Përfitues të këtij fondi, kanë qenë 54 nxënës shqiptarë, kroat dhe të komunitetit RAE të shkollës fillore "Shtjefën Gjeçovi" si dhe 30 nxënës të shkollës fillore "Vesel Muja". Përmes këtyre projekteve dhe falë bashkëpunimit të mirë që ka FSK-ja me Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë, më saktësisht me EMCU-në, po realizohen projekte në ndihmë të qytetarëve të Kosovës, pa dallime etnie. Ky donacion, tash me fillimin e vitit të ri shkollorë, do të jetë një ndihmesë e madhe për nxënësit dhe familjet të cilat kanë një jetë të vështirë materiale.

Pjesëtarët e FSK-së përfunduan me sukses trajnimin "Bjeshkataria"

Në bazën ushtarake të KFOR-it "Fshati Italian" në Pejë, u mbajt ceremonia e certifikimit të 15 pjesëtarëve të Batalionit të Tretë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë, të cilët përfunduan me sukses trajnimin "Bjeshkataria". Trajnimi është zhvilluar nga data 10-21 shtator 2018, ku ligjërues dhe vlerësues të trajnimit ishin oficerët e KFOR-it italian. Ky trajnim u zhvillua në formë të kombinuar, ligjërata dhe punë praktik në terren, ku u testuan pjesëtarët e FSK-së në marshim, navigim, ndihmë të parë, via ferrata, lëshim me litar nga Bjeshkët e Rugovës, si dhe në disa fusha që ndërlidhen me bjeshkatari. Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëtarët e FSK-së, përkatësisht të Batalionit të Tretë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë, të pajisen me njohuri dhe të fitojnë përvoja në fushën e bjeshkatarisë nga KFOR-it italian. Instruktorët e KFOR-it italian u ndanë mjaft të kënaqur me paraqitjen e pjesëtarëve të Batalionit të Tretë dhe me ecurinë e gjithë trajnimit, ku të gjithë pjesëmarrësit i certifikuan dhe për më të dalluarit ndan edhe mirënjohje. Në certifikim morën pjesë zv. komandanti i BRSH-së, kolonel Hysen Dreshaj dhe zv. komandanti i BAT 3 të BRSH-së, major Avni Kiqina. Kolonel Dreshaj, në fjalën e tij, pasi falënderoi KFOR-in italian për mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme, ai njëherësh i përgëzoi edhe pjesëtarët pjesëmarrës të këtij trajnimi për angazhimin dhe disiplinën e treguar.

Intervistë me dhuruesit e dalluar të gjakut në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kapteri Fehmi Hajra dhuroi mbi 27 herë gjak

Humaniteti dhe vullneti nuk mungojnë asnjëherë te pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve, në veçanti atyre që kanë nevoja të ndryshme shëndetësore. Një nder aktivitetet humanitare të pjesëtarëve të Batalionit të Tretë të BRSH-së në Mitrovicë është edhe dhurimi vullnetar i gjakut. Ky aksion organizohet dy herë gjatë vitit nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës dhe realizohet në bashkëpunim me Kompaninë e Mjekësisë dhe Departamentin për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të MFSK-së. Si gjithherë, pjesëtarët e FSK-së iu përgjigjen këtij aksioni me vullnetin më të madh. Pa hezitim mund të themi se janë dhuruesit më të mëdhenj të gjakut në nivel shteti. Kësaj here për gazetën „Forca Jonë" intervistuam pjesëtarin e Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë, kapterin Fehmi Hajra, i cili është njëri ndër dhuruesit e rregullt të gjakut që edhe



në mënyrë individuale u përgjigjet kërkesave të qytetarëve për t'iu dalë në ndihmë kur kanë nevojë për gjak.

Fehmi Hajra është infermier në Batalionin e Tretë të BRSH-së në Mitrovicë. Edhe pse ka dhuruar gjak mbi 27 herë, është tepër modest dhe për veten asnjëherë nuk dëshiron të flasë. Kapteri Hajra, për herë të parë ka dhënë gjak në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) e pastaj në vazhdimësi në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Si dhurues vullnetar i gjakut a mund të na thoni që sa vite dhuroni gjak dhe sa herë keni dhuruar deri me tani ?

Kapter Hajra: Pas dhurimit të gjakut, në trupin tim ndiej një lehtësim fizik, ndërsa në aspektin shpirtëror një kënaqësi të veçantë; kur e di se me gjakun që dhuroj, i ndihmoj atij që ka nevojë më së shumti për "lëngun e jetës"(gjakun). Kur arrihet të shpëtohet jeta e njeriut, sigurisht që është mrekulli njerëzore

Ju jeni dhurues i rregullte i gjakut!?

Kapter Hajra: Po, për herë të parë kam dhënë gjak, gjatë kohës sa kam shërbyer në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës. Ky proces nuk është aspak i vështirë. Ndikon pak edhe përgatitja nga ana psikike. Unë, tani rregullisht jap gjak dy herë gjatë vitit, por u përgjigjem edhe kërkesave të tjera të qytetarëve kur kanë nevojë për gjak. Dhurimi i gjakut për mua është diçka e shenjtë; për arsyen e vetme se shpëton një jetë, dhe shpëtimi i një jete jo vetëm që është shumë i rëndësishëm por edhe humanizëm.

Shokët tuaj thonë se ju keni dhuruar gjak dhjetëra herë!?

Kapter Hajra: Kam dhënë dhe do të vazhdoj të jap gjak. Derisa të kam shëndet të mirë nuk do të ndalem asnjëherë. Dhurimi i gjakut ndikon pozitivisht edhe në procesin e metabolizmit. Deri më tani mbi 27 herë kam dhuruar gjak për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës.

Pasi që jeni infermier me profesion, a mund të thoni si ndikon në trupin/shëndetin e njeriut dhurimi i gjakut ?

Kapter Hajra: Në aspektin shëndetësor, dhurimi i gjakut trupit i bënë mirë, pasi që rruazat e bardha dhe rruazat e kuqe të gjakut kanë nevojë të ripërtërihen. Rruazat e kuqe-qeliza të gjakut me ngjyrë të kuqe, pa bërthamë, që çojnë oksigjenin nga mushkëritë në të gjitha indet e trupit. Rruazat e bardha-qeliza të gjakut pa ngjyrë, që kanë vetinë të kapin e të mbytin mikrobet ose të gëlltitin lëndët e tjera të huaja që hyjnë në organizëm.

Cili është mesazhi juaj, për ata të cilët ngurrojnë ende të japin gjak?!

Kapter Hajra: Unë ju bëjë thirrje të gjithë atyre që ende ngurrojnë të japin gjak, të cilët janë mirë me shëndet, të dhurojnë gjak, pasi që dikush ka nevojë dhe t'i mund të jesh shpëtimtari i një jete, por edhe në aspektin fizik duke dhuruar gjak i bëni mirë edhe trupit tuaj.

Duke e përmbyllur intervistën me kapterin Fehmi Hajra, falënderojmë edhe të gjithë dhuruesit e gjakut në FSK, të cilët i përgjigjen dy herë në vit aksionit vullnetar me moton „Dhuro gjak-shpëto jetë".

Koncert i përbashkët i Orkestrës frymore të FSK-së dhe Orkestrës Ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar

Në amfiteatrin e kazermës ,,Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, është mbajtur një koncert i përbashkët i Orkestrës Frymore të FSK-së dhe Instruktorëve të Orkestrës Ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar. Pas një trajnimi treditor të orkestrës frymore të FSK-së, nga instruktorët e ushtrisë të Mbretërisë së Bashkuar, kanë realizuar vepra të kompozitorëve me famë botërore, me motive ushtarake; marshe dhe vepra të njohura, si: Marshi i FSK-së, Sancarlo, Last Post, që zakonisht interpretohen për të përkujtuar të rënët në nderim të tyre. Për të përcjellë paraqitjen e orkestrës frymore të FSK-së dhe të ushtrisë nga Mbretëria e Bashkuar, ishin të pranishëm edhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale gjeneral brigade Naim Haziri, këshilltari i anglez i komandantit të FSK-së nënkoloneli Paul Stainthorpe, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së dhe KFOR-it. Instruktorët nga ushtria e Mbretërisë së Bashkuar u ndanë të impresionuar nga profesionalizimi i pjesëtarëve të Orkestrës Frymore të FSK-së, dhe u shprehën të gatshëm për vazhdimin e bashkëpunimin edhe në të ardhmen. Bashkëpunimi me ushtrinë e Mbretërisë së Bashkuar në fushën e muzikës ka filluar që nga viti 2013, ku instruktorët nga Royal Marin Band kanë mbajtur trajnime me Orkestrën Frymore të FSK-së. Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral Enver Cikaqi, në shenjë falënderimi, ndau mirënjohje për instruktorët e Britanisë së Madhe.

FSK-ja me kapacitete njerëzore dhe teknike në aksionin gjithëkombëtar „Ta pastrojmë Kosovën"



Sot, (15.09.2018) në afërsi të ujësjellësit rajonal "Prishtina", kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj hapi aksionin vullnetar gjithëkombëtar ,,Ta pastrojmë Kosovën'', aksion ky që do të zgjasë për tre muaj rresht. Në këtë ngjarje ishte i pranishëm edhe ministri i FSK-së Rrustem Berisha, i shoqëruar nga zëvendësministri Burim Ramadani dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së gjeneral brigade Enver Cikaqi. Këtij aktiviteti nga MFSK dhe FSK-ja i janë përgjigjur vullnetarë të shumtë, si zyrtarë, oficerë, kadetë dhe ushtarë. Duke vlerësuar lart rëndësinë e këtij aksioni, ministri i FSK-së z. Berisha shprehu mirënjohje dhe përgëzoi të gjithë pjesëtarët që janë angazhuar në detyra të ndryshme në kuadër të mbështetjes së këtij aksioni. Ai me këtë rast edhe një herë ju bëri thirrje të gjithë pjesëtarëve të MFSK-së dhe FSK-së dhe gjithë qytetarëve të Kosovës, që edhe individualisht ta ndihmojnë këtë aksion në mjediset ku ata jetojnë. Në këtë aksion, përveç forcës njerëzore, FSK ka angazhuar një numër të madh të mjeteve teknike xheniere, makineri dhe mjete të shumta transporti në 7 komuna të Kosovës.

Një kontingjent prej 50 oficerësh të Gardës Kombëtare të Ajovës qëndroi për vizitë zyrtare në Kosovë

Bazuar në Programin e Partneritetit Shtetëror Kosovë – Ajovë, përkatësisht të partneritetit të Forcës së Sigurisë të Kosovës me Gardën Kombëtare të Ajovës (SHBA), 50 pjesëtarë nga ,,Staff Ride", prej tyre oficerë dhe nënoficerë të Gardës Kombëtare të Ajovës, po qëndrojnë për vizitë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në mjediset e FSK-së, ushtarakët e Gardës Kombëtare të Ajovës, i priti dhe ju uroi mirëseardhje komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj. Dhe më pas, në amfiteatrin e kazermës ,,Adem Jashari", u realizua një takim informues nga rreshter majorët Genc Metaj dhe Fetah Zejnullahu, të cilët u fokusuan në historikun e FSK-së, arritjet e saj të deritanishme, misionin, detyrat, strukturën, trajnimet/ushtrimet, bashkëpunimin me institucione të tjera, etj. Krahas kësaj, pjesëtarët e kontingjentit amerikan dhe pjesëtarët e FSK-së



filluan aktivitete të përbashkëta sportive në disa disiplina, të cilat do të zhvillohen edhe gjatë ditëve në vazhdim. Gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, ushtarakët amerikanë do të shoqërohen nga pjesëtarët e FSK-së dhe do të kenë mundësi të njihen edhe nga afër me kapacitetet e FSK-së, me kulturën dhe traditën shqiptare dhe të komuniteteve tjera. Po ashtu do të vizitojnë vende të rëndësishme në Kosovë si dhe do të zhvillojnë takime me liderët e FSK-së dhe të institucioneve të tjera. Ushtarakët e Gardës Kombëtare të Ajovës do të vazhdojnë të qëndrojnë në FSK, sipas agjendës, deri më 21 shtator 2018.

Certifikohen pjesëtarë të BRSH-së në "Operacionet e mbështetjes së paqes"

Në kazermën e Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Istog, (28.09.2018), janë certifikuar 23 pjesëtarë të FSK-së, nga instruktorët e BMATT-it (British Military Advisor Training Team), pas një trajnimi 4 javor në "Operacionet e mbështetjes së paqes".

Në ceremoninë e certifikimit, komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hdërgjonaj, ka falënderuar ekipin e instruktorëve anglez dhe Ushtrinë Britanike, për angazhimin e tyre, të cilët nuk kursyen kohën dhe mundin që t'i trajnojnë pjesëtarët e FSK-së, të cilët në vazhdimësi që nga fillimi e kanë mbështetur Forcën e Sigurisë së Kosovës në avancimin dhe profesionalizmin e saj. Gjenerali Hadërgjonaj i ka uruar edhe pjesëtarët e certifikuar dhe i ka inkurajuar, që disiplina, profesionalizmi dhe motivimi të jenë pjesë e jetës së tyre ushtarake. Ndërkaq, instruktori anglez, Anthony HILL, shef i ekipit të BMATT-it, ka vlerësuar lart gatishmërinë, vullnetin, angazhimin dhe përkushtimin e pjesëtarëve të BRSH-së gjatë trajnimit, duke nënvizuar se FSK-ja është me fat që ka pjesëtarë të tillë në radhët e saj. Pjesëtarët që ndoqën këtë trajnim janë vlerësuar me testim me shkrim dhe në bazë të paraqitjes që ata kanë treguar në terren është bërë edhe e më të mirëve. Në vendin e tretë u radhit Kreshnik Dreshaj, në vendin e dytë Bujar Prekadini dhe në të parin Ilir Hajra.

U mbajt certifikimi i trajnimit "Zhytje në ujë" niveli i avancuar

Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së, (QTKSH) në Pomozatin, është mbajtur ceremonia e certifikimit të 6 pjesëtarëve nga njësi të ndryshme të FSK-së, të cilët kanë përfunduar me sukses kursin tre javor të nivelit të avancuar të zhytjes. Duke pasur të përfunduar nivelin bazik të këtij kursi, si dhe atë të mbijetesës në ujë, studentët



duhej të ballafaqoheshin dhe të kalonin shumë sfida në mënyrë që të kualifikoheshin për të vijuar kursin e avancuar të zhytjes në ujë.

Java e parë përbënte pjesën teorike të zhvilluar brenda në klasë, dhe më pas testimin në pishinën e Banjës në Malishevë. pastaj studentët kaluan 2 javë praktikë në liqenin e Batllavës, duke përfituar përvojë të zhytjes në kushte të vështira.

Gjatë testimit të rreptë, studentët duhej të kryenin një numër të detyrave dhe procedurave të sigurisë në një thellësi minimale prej 15m nën sipërfaqe të ujit. Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm edhe komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri, zëvendëskomandant i Brigadës së Mbështetjes Operacionale, koloneli Avdi Raci dhe Genc Metaj, rreshter major i parë i FSK-së.

FSK-ja, Policia e Kosovës dhe Ambasada amerikane realizuan trajnim të përbashkët për K9

Në kuadër të bashkëpunimit që ka FSK-ja me Ekipin për Mbështetje Civilo-Ushtarake të Ambasadës amerikane në Prishtinë, nga data 17-19.09. 2018, në Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, është realizuar trajnimi K9 (Puna me qen) për FSK-në dhe Policinë e Kosovës. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 7 pjesëtarë të FSK-së dhe 11 pjesëtarë të Policisë së Kosovës, si dhe ekipi i instruktorëve dhe veterinarëve nga EMCU pranë Ambasadës amerikane. Njësitet pjesëmarrëse në trajnim ishin: Task Forca e Kërkim-Shpëtimit, Kompania e Deminimit, Policia e Kosovës, Policia Kufitare dhe Ekipi për Mbështetje Civilo-Ushtarake i Ambasadës amerikane në Prishtinë. Në trajnim u realizuan ligjërata dhe u shkëmbyen përvoja rreth punës me qen në disa fusha, si: kërkim-shpëtim, deminim, puna në identifikimin e materieve narkotike, kontrolla mjekësore e qenve etj. Pjesëmarrësit e këtij trajnimi, me anë të skenarëve të ndryshëm, patën mundësi që në praktikë të fitojnë përvoja të ndryshme për sa i përket punës në aspektin K9.



FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 73 • 09 Nëntor 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

Presidenti Thaçi priti ekipin e FSK-së që fitoi Medaljen e Bronztë në garën "Cambrian Patrol" në Mbretërinë e Bashkuar

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, më 22 tetor 2018, ka pritur ekipin e Forcës së Sigurisë së Kosovës që ka marrë pjesë në garën "Cambrian Patrol" në Britani të Madhe, ku ka fituar Medaljen e Bronztë.

Presidenti Thaçi e ka falënderuar komandantin Rrahman Rama dhe ekipin e Forcës së Sigurisë së Kosovës për punën e mrekullueshme që po bëjnë, duke u bërë shembull i mirë për tërë rajonin. "Gjenerali edhe ekipi i tij, me këta eprorë e ushtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, janë shembulli dhe mesazhi më i mirë që po dërgohet, se FSK-ja është e gatshme për përgjegjësi shtesë. Është e gatshme t'i përgjigjet rrethanave dhe situatave të reja të krijuara.



I përgëzoj eprorët, togerët, ushtarët e FSK-së dhe komandantin për punën e tyre shumë të mirë, por edhe për suksesin e ri, të shkëlqyer që e kanë arritur ditë më parë me pjesëmarrjen e tyre në garën në Britani, ku kanë marrë pjesë 144 ekipe", ka thënë presidenti Thaçi. Ndërsa, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrahman Rama, ka thënë se kjo është një prej garave më prestigjioze në botë dhe Forca e Sigurisë së Kosovës po merr pjesë për herë të dytë.

"Është shumë me rëndësi që këto përvoja po i bartim edhe brendapërbrenda institucionit tonë. Edhe në vitin e kaluar e kemi organizuar një lloj kësi gare, të cilën e kemi quajtur "Shqiponja patrulluese". Ideja ka qenë që ta bëjmë një test të brendshëm, me qëllim dhe synim që vitin e ardhshëm ta bëjmë vetë një garë që do të jetë ndërkombëtare, me të gjitha ato përvoja që i kemi marrë prej Mbretërisë së Bashkuar", ka thënë komandant Rama.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës ka thënë se janë të gatshëm që të marrin përgjegjësi shtesë dhe do të vazhdojnë me kryerjen e obligimeve dhe detyrave që u caktohen me ligj dhe Kushtetutë. Gara e "CambrianPatrol" është një ngjarje vjetore e organizuar dhe drejtuar nga Brigada e Këmbësorisë së 160-të dhe Selia e Uellsit, me seli në Brecon të Britanisë së Madhe. Forca e Sigurisë së Kosovës këtë vit ka marrë pjesë me 11 pjesëtarë në këtë garë ndërkombëtare dhe pavarësisht vështirësive të krijuara nga stuhia "Cullum", ka arritur ta fitoi Medaljen e Bronztë.



Deputetët e Kuvendit të Kosovës votuan në lexim të parë tri Projektligjet për MFSK/FSK-në

Pas rezymeve të ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Rrustem Berisha, për tri Projektligjet për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës/Forcën e Sigurisë së Kosovës, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 18.10.2018, votuan në lexim të parë: Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ekspozetë për tri Projektligjet e Forcës së Sigurisë të Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës i paraqiti ministri Rrustem Berisha.

(Vazhdon në faq 4,)

Ministri Rrustem Berisha priti në vizitë ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës z. Rrustem Berisha priti më 23 tetor 2018, në vizitë zyrtareministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi z. Predrag Boshkoviç.

Ministri Berisha dhe Boshkoviç së pari zhvilluan një takim kokë më kokë, për të vazhduar më pastaj me një takim të përbashkët të dy delegacioneve. Në delegacionin e FSK-së ishin të pranishëm Faruk Geci, drejtor i Politikave dhe Planeve në MFSK, Jashar Ramadani, shef i Kabinetit të Ministrit, majori Hisen Berisha, këshilltar ushtarak i ministrit dhe Elena Çitaku, këshilltare politike e ministrit, kurse pjesë e delegacionit të Mali i Zi ishte ambasadori Ferhat Dinosha, IvicaIvanoviç, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Politikave të Mbrojtjes, BojanaMartinovic, shef i Kabinetit të ministrit Boshkoviç dhe koloneli ZoranBoshkoviç këshilltar i ministrit për çështje ushtarake.

Ministri Berisha pasi i dëshirojë mirëseardhje ministrit Boshkoviç, e njohu atë edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, ngritjen profesionale dhe procesin e tranzicionit të FSK-së.

Gjatë takimit, të dy ministrat biseduan edhe për bashkëpunimin e deritashëm, marrëdhëniet e mira dypalëshe, vazhdimin e bashkëpunimi në të ardhmen si dhe për mbështetjen reciproke të bazuar në memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive. Ministri Berisha njëherësh e falënderojë ministrin Boshkoviç për bashkëpunimin e mirë dhe konkret të Ministrisë që ai drejton, gatishmërinë për zgjerimin e bashkëpunimit edhe në fusha të tjera, shkëmbimet në fushën e trajnimeve dhe shkollimeve, si dhe për pjesëmarrjen në ushtrime të përbashkëta fushore. Gjithashtu ministri Berisha e njoftojë hologun malazias edhe për mundësinë e studimit të kadetëve të Malit të Zi në Qendrën e Studimeve Universitare që nga viti i ardhshëm. Ministri Berisha, po ashtu konfirmoi marrëdhëniet e mira me vendet e rajonit, bashkëpunimin e mirë me vendet anëtare të NATO-s dhe vendet që aspirojnë për t'u anëtarësuar në NATO. Në kontekst të kësaj, ministri Berisha kërkoi nga ministri Boshkoviç, mbështetjen për anëtarësimin e MFSK/FSK-së me të drejta të plota në Kartën e Adriatikut–A5. Ndërsa, ministri Boshkoviç tha se Ministria e Mbrojtjes të Malit të Zi është e gatshme për zgjerimin dhe avancimin e bashkëpunimit me Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Forcën e Sigurisë të Kosovës.



Takimet e shumta të delegacionit të MFSK/FSK-së, në SHBA

Në Pentagon takohet Grupi Punues për Politika të Sigurisë SHBA-Kosovë

Në Pentagon takohet Grupi Punues për Politika të Sigurisë SHBA-Kosovë Delegacioni i MFSK/FSK-së, gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, realizoi takime dypalëshe lidhur me avancimin e marrëdhënieve Kosovë-SHBA, në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Zëvendësministri për FSK-në, z. Burim Ramadani dhe zëvendës ndihmësja e Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes, znj. Laura Cooper, kanë bashkë-kryesuar mbledhjen e Grupit Punues për Politika të Sigurisë SHBA-Kosovë, të mbajtur në Pentagon.



Gjatë takimit të Grupit të përbashkët, janë diskutuar dhe vendosur orientimet strategjike në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe SHBA-ve. Po ashtu, janë diskutuar çështjet e detajuara mbi angazhimet e përbashkëta në mbështetjen amerikane për Ministrinë e ardhshme të Mbrojtjes, me theks të veçantë për FSK-në në mandatin dhe detyrat e reja ushtarake dhe të mbrojtjes. Në takim ishte edhe komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, ambasadorja Vlora Çitaku dhe delegacioni profesional. Të dy delegacionet kanë prezantuar synimet dhe planet për punën e përbashkët, në vitin në vijim, sikurse janë dakorduar për një varg aktivitetesh mbështetëse për FSK-në, anëtarësimin në iniciativat rajonale, si dhe angazhimet në misione ndërkombëtare.

Në takimin e mbajtur në Washington është prezantuar rruga përpara gjatë transicionit të FSK-së pas miratimit të ligjeve në Kuvendin e Kosovës. Bashkë-kryesuesit Ramadani dhe Cooper kanë vlerësuar lart përgatitjet e bëra nga të dy delegacionet për bashkëpunimin bilateral dhe theksuan thellimin e partneritetit në siguri e mbrojtje Kosovë-SHBA.

Delegacioni i FSK-së pritet në Washington DC nga Senatorja Joni Ernst



Zëvendësministri i FSK-së, Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (11.10.2018) janë pritur nga senatorja Joni Ernst në Washington D.C. Në takimin që zhvilloi delegacioni i MFSK-së me senatoren nga Iowa u diskutua për angazhimet e përbashkëta Kosovë-SHBA në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe për aftësimin e Kosovës në përballje me sfidat rajonale dhe globale. Zv. ministri Ramadani vuri theksin tek orientimi i Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e kapaciteteve të FSK-së në mandatin ushtarak dhe të mbrojtjes bazuar në standardet amerikane. "Për Kosovën është jetësore të vazhdojë ndërtimi i FSK-së me standarde amerikane në doktrinë, lidership, sistem të armatimit dhe në pajisje", tha z. Ramadani, duke shprehur orientimin e Kosovës për partneritet të plotë me SHBA-të.

Ndërsa, komandanti gjenerali Rrahman Rama, nënvizoi gatishmërinë e FSK-së për të kontribuar në sigurinë e rajonit dhe më gjerë. "FSK është e gatshme të fillojë tranzicionin në mandat ushtarak, duke u bazuar në Planin afatgjatë që e kemi të koordinuar. FSK-ja do të vazhdojë të jetë profesionale, shumetnike, e besueshme dhe e gatshme", tha gjeneral Rama. Ndërkaq, senatorja Ernst shprehu vullnetin dhe gatishmërinë e saj për vazhdimin dhe mbështetjen e Kosovës në ndërtimin e kapaciteteve për siguri dhe mbrojtje. Në takimin mori pjesë edhe ambasadorja Vlora Çitaku, shefi i kabinetit të Ministrit të FSK-së Jashar Ramadani, atasheu i Mbrojtjes së Kosovë kolonel Ilir Qeriqi, diplomati Frymëzim Isufaj dhe atasheu amerikan i Mbrojtjes në Kosovë koloneli RyanNichols.

Delegacioni i MFSK-së zhvilloi takime të ndara në Senat dhe në Departamentin e Shtetit



Delegacioni i MFSK/FSK-së, më 13.10.2018, ka zhvilluar takime zyrtare në Senatin Amerikan dhe në Departamentin e Shtetit. Zv. ministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, janë pritur në Washington D.C, në takime të ndara nga senatori GaryPeters, si dhe nga zëvendës ndihmës Sekretari i Shtetit, MathewPalmer. Në takimin me Senatorin GaryPeters, u diskutua për angazhimet e përbashkëta Kosovë - SHBA në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Gjithashtu u diskutua për aftësimin e Kosovës në përballjen me sfidat rajonale dhe globale. Ndërsa, në takimin me zëvendës ndihmës Sekretarin e Shtetit, MattewPalmer, u diskutua mbi procesin e tranzicionit të FSK-së, planin afatgjatë të zhvillimit dhe përpjekjet e Kosovës në marrëdhëniet rajonale dhe euro-atlantike. Gjatë takimeve të përbashkëta, z. Peters dhe Palmer theksuan mbështetjen e vazhdueshme të SHBA-ve për Kosovën.

Në FSK u prit kryesuesi i Komitetit Ushtarak të NATO-s



Kryesuesi i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal SerStuart Peach, i shoqëruar edhe nga komandanti i KFOR-it SalvatoreCuoci dhe ekipi i tij përcjellës, më 6 tetor 2018, ishte për vizitë në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ku u prit nga komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, i cili shoqërohej nga komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, atasheu i FSK-së në Bruksel Ahmet Ajeti dhe koloneli Jeton Dreshaj. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama e njoftoi kryesuesin e Komitetit Ushtarak të NATO-s për zhvillimet në FSK; kapacitet aktuale, personelin, profesionalizimin, integrimin e komuniteteve pakicë, operacionet, trajnimet, pjesëmarrjen në ushtrime fushore të përbashkëta, bashkëpunimin e ngushtë me KFOR-in, si dhe me sfidat që e presin FSK-në në zhvillimet e mëtejshme.

Ndërsa, kryesuesi i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal SerStuartPeach, përgëzoi komandantin e FSK-së gjeneral Ramën dhe përmes tij FSK-në, për punën e mirë të deritashme dhe sukseset e arritura në shumë fusha. Kryesuesi i Komitetit Ushtarak të NATO-s është pritur me ceremoni ushtarake, me rreshtim të Togut Ceremonial dhe Orkestër Frymore të FSK-së.

Komandanti i FSK-së priti në vizitë shefin e Mbrojtjes të Gjermanisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti më29 tetor 2018, në mjediset e ministrisë shefin e Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë, gjeneral EberhardZorn. Gjeneral Rama dhe gjenerali Zorn si bashku me delegacionet e tyre zhvilluan një takim të përbashkët, ku diskutuan për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Gjermanisë dhe Kosovës, përkatësisht Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së duke e falënderuar shefin e Mbrojtjes së Gjermanisë për kontributin e dhënënë kuadër të KFOR-it, si shtet anëtar i NATO-s, u shpreh se Ministria për FSK dhe FSK-ja, në kuadër të marrëveshjes dypalëshe të bashkëpunimit, kanë marrëdhënie shumë të mira me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë dhe se këto marrëdhënie do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Gjeneral Rama më tej e njoftoi homologun e tij, gjeneralin Zorn, me kapacitetet ekzistuese, aktivitetet në të mirë të qytetarëve, integrimin e komuniteteve, planet zhvillimore dhe me theks të veçantë mbi procesin e tranzicionit të FSK-së, fazën në të cilën aktualisht ndodhet dhe transparencën e këtij procesi, duke shprehur zotimin se Kosova po synon të



ndërtojë një forcë me mision dhe detyra të reja, e cila do të jetë fleksibile, shumetnike, e dobishme për sigurinë në vend dhe më gjerë, dhe se kjo do të bëhet në një transparencë të plotë me faktorin vendor, ndërkombëtar dhe aleatët strategjikë, duke përfshirë këtu si partner edhe Republikën Federale Gjermane.

I pari i FSK-së, gjeneral Rama më tej tha se "ne jemi të vendosur të zbatojmë planin mbi tranzicionin e Forcës dhe se edhe më tutje do të punojmë ngushtë me faktorin vendor dhe ndërkombëtar me qëllim që si vend të jemi të përgatitur të kontribuojmë për paqen jo vetëm në vend por edhe në rajon e më gjerë".

Nga ana e tij, shefi i Mbrojtjes i Republikës Federale Gjermane nënvizoi se "Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë janë të vendosura që bashkëpunimin bilateral me MFSK-në dhe FSK-në ta vazhdojnë dhe intensifikojnë edhe në të ardhmen".

Ministri Berisha takoi pjesëtarët e FSK-së nga radhët e komunitetit serb



Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, më 17.10.2018, vizitoi Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së në Pomozotin, ku u prit nga komandanti i RMC-së kolonel Shaip Haziri. Ministri Berisha së pari u njoftua shkurtimisht nga kolonel Haziri për punën dhe aktivitetet e njësisë që ai komandon, gjendjen e personelit, raportet ndërnjerëzore si dhe me kushtet e punës të pjesëtarëve të FSK-së në RMC dhe në njësitë e saja të specializuara. Ministri Berisha i shoqëruar nga kolonel Haziri dhe shefja e Zyrës për Komunitete në MFSK, zonja Lejla Loci zhvilluan një takim të hapur me pjesëtarët e FSK-së nga radhët e komuniteteve, veçanërisht të komunitetit serb, që shërbejnë në disa prej njësive të Brigadës për Mbështetje Operacionale. Me këtë rast, ministri Berisha foli mbi rëndësinë e zhvillimeve aktuale në FSK, motivimin dhe angazhimin e të gjithë pjesëtarëve të FSK-së pa dallim në kryerjen e detyrave të tyre. "FSK-ja ka dëshmuar se është institucion shumetnik dhe se me kapacitetet që ka është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim nga përkatësia etnike, gjinore, fetare dhe racore" –shtoi ndër të tjera ministri Berisha.

I pari i FSK-së, z. Berisha i përgëzoi pjesëtarët e komunitetit serb që shërbejnë në FSK, të cilët edhe përkundër presioneve të ndryshme politike, për të cilat është në dijeni edhe faktori ndërkombëtar, janë të vendosur që të shërbejnë në FSK, në të mirë të qytetarëve që jetojnë këtu. Në vazhdim, ministri Berisha shprehu keqardhje për disa pjesëtarë të komunitetit serb, të cilët janë demobilizuar. "Ndjehem mirë që asnjëri prej pjesëtarëve që kanë paraqitur kërkesë për demobilizim nuk kanë pasur ankesa sa i përket trajtimit, punës apo marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe ndëretnike në FSK. Në këtë aspekt më gëzon fakti se çdo ditë ka kërkesa nga të rinjtë e këtij komuniteti për t'u rekrutuar në FSK". Ministri Berisha, në fjalën e tij i garantoi pjesëtarë e komunitetit serb, që FSK-ja është institucion i të gjithëve që jetojnë në Kosovë dhe se FSK-ja është dhe do të jetë institucion shumetnik, dhe se ndërtimi dhe zhvillimi i Forcës e përfaqësuar nga të gjithë dhe në shërbim të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ministri Berisha, në fund i dëgjoi me vëmendje diskutimet e pjesëtarëve të FSK-së; që kishin të bënin, për çështjet e jetës, punës dhe shërbimit në FSK, udhëtimit, trajnimeve, avancimeve si dhe të tjera lidhura me punën e përditshme në institucion. Vlen të ceket se të gjithë diskutuesit shprehën gatishmërinë për shërbim në FSK, dhe se nuk vunë në diskutim ndonjë dilemë, përveç se bashkërisht me pjesëtarët e tjerë të zhvillohen dhe të punojnë në të mirë të FSK-së si institucion i cili u shërben të gjithë qytetarëve të shtetit të Kosovës.

Sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj në „Konferencën vjetore të NATO-s" në Romë



Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. ShkelzenSylaj i shoqëruar nga sekretari personal Florin Hoxha, (11.10.2018) morri pjesë në "Konferencën vjetore të NATO-s për Ngritje të Integritetit" (NATO AnualDefenceConfernceforBuildingIntegrity) , që u mbajt në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s (NATO DefenceCollege) në Romë, Itali, me organizim të NATO-s dhe mbështetje të CIDS (Qendra Norvegjeze për Ndërtimin e Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes) nga Norvegjia.

Fjalimin kryesor gjatë punimeve të kësaj konference e mbajti Sekretari i përgjithshëm i MFSK -së z. Shkelzen Sylaj, i cili i njoftojë të pranishmit me të arriturat e MFSK–së në ngritjen e integritetit. Ai po ashtu, ka ofruar kapacitetet profesionale të Ministrisë së FSK-së në përkrahje të shteteve që janë në fazën e hartimit të planit të integritetit në institucionet e tyre.

Në këtë konferencë po marrin pjesë ekspertë nga vende të ndryshme anëtare të Aleancës Veri-Atlantike-të NATO-s si dhe përfaqësues të institucioneve nga shtetet aspiruese, duke përfshirë këtu edhe shtetet nga rajoni, si Mali i Zi, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina etj. Konferenca vjetore e NATO-s për Ngritje të Integritetit (NATO AnualDefenceConfernceforBuildingIntegrity) ka filluar dje më 10 tetor dhe do të përfundojë punimet sot, më 11 tetor 2018.

EKSPOZE e Ministrit Brisha për tri projekt ligjet e Ministrisë dhe FSK-së

(Vijon nga ballina)

PROJEKTLIGJI PËR MINISTRINË E MBROJTJES

Të nderuar, Hartimi dhe procedimi i Projektligjit për Ministrinë e Mbrojtjes, është bërë në kuadër të normave aktuale kushtetuese, ashtu që ky projektligj, parasheh që të bëhet riorganizimi dhe kalimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministri të Mbrojtjes në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të mbikëqyrjes dhe kontrollit civil demokratik mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ky projektligj parasheh që Ministria e Mbrojtjes të ketë strukturën e saj organizative që siguron funksionalizimin e plotë dhe përmbushjen e përgjegjësive të saj. Ministria e Mbrojtjes do të harton dhe zbaton politikat e përgjithshme shtetërore të mbrojtjes në nivelin strategjik, si dhe do të ushtron funksionet e kompetencat e saj në përputhje me Kushtetutën, me ketë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Ministria e Mbrojtjes do të jetë e përbërë nga shërbyesit civil dhe nga personeli ushtarak i FSK-së. Po ashtu, ky projektligj përcakton në mënyrë të detajuar edhe kompetencat e Ministrisë, kompetencat e Ministrit të Mbrojtjes e po ashtu edhe kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm. Të gjitha ndryshimet e parapara me këtë ligj do të bëhen konform fazave të përcaktuara në rekomandimet e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe të detajuara në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit.



PROJEKTLIGJI PËR FORCËN E SIGURISË TË KOSOVËS

Të nderuar, Sot para jush paraqes propozimin e MFSK-së për Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Hartimi dhe procedimi i këtij projektligji, është bërë në kuadër të normave aktuale kushtetuese që i referohen FSK-së, ashtu që ky projektligj parasheh që Forca e Sigurisë së Kosovës të zhvillohet si një forcë me kompetenca të reja, organizim dhe funksionim të ri, si mekanizëm i sektorit të sigurisë me detyra të mbrojtjes së integritetit territorial, qytetarëve, pronës dhe interesave të Republikës së Kosovës. Përkatësisht: Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës - përcakton kompetencat, organizimin dhe funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si forcë multietnike, profesionale, e armatosur dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me mandatin e dhënë kushtetues dhe ligjor, në mbrojtje të integritetit territorial, qytetarëve, pronës dhe interesave të Republikës së Kosovës, dhe e cila i nënshtrohet kontrollit civil demokratik. Është me rëndësi të theksohet se: në momentin e krijimit të kushteve të favorshme politike- vendimmarrëse, procesi i evoluimit dhe transformimit të FSK-së do të ndjekë procedurat e ndryshimeve përkatëse kushtetuese.

PROJEKTLIGJI PËR SHËRBIM NË FORCËN E SIGURISË TË KOSOVËS

Të nderuar, Sot para jush paraqes propozimin e MFSK-së për Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Hartimi dhe procedimi i këtij projektligji, është bërë në kuadër të normave aktuale kushtetuese që i referohen FSK-së. Projektligji për Shërbimin në FSK, me dispozitat e tij rregullon kushtet e përgjithshme të shërbimit në Forcën e Sigurisë të Kosovës, si një shërbim i ndërtuar mbi bazën e parimit të ligjshmërisë, profesionalizmit, komandës, disiplinës, respektit, nderit, ruajtjes së informacionit, komunikimit, jodiskriminimit dhe mundësive të barabarta, paanshmërisë politike, transparencës dhe llogaridhënies. Ky projektligj përcakton: - kriteret e përgjithshme për shërbim, parametrat e shërbimit, -kohëzgjatjen e shërbimit, -zhvillimin e karrierës, - ndërprerjen e shërbimit, -statusin e pjesëtarit të FSK-së, - të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve dhe çështje tjera në kuadër të shërbimit në FSK.Në parim të tri Projektligjet: Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, sot u aprovuan nga deputet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në Konferencën e Shefave të Mbrojtjes në Gjermani

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 19 tetor 2018 mori pjesë në Konferencën e 26-të vjetore të shefave të Mbrojtjes në Wiesbaden të Gjermanisë. Në këtë konferencë morën pjesë mbi 39 shefa të Mbrojtjes nga shtetet evropiane, anëtare të NATO-s dhe shtetet partnere.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama në Wisbaden u takua me shefin e Shtabit të Ushtrisë Amerikane gjeneralin Mark-Milley dhe gjenerallejtënant Christopher Cavoli, komandant i Ushtrisë Amerikane për Evrope, si dhe me homologë të shumtë nga shtetet mike të Kosovës.

Konferenca e shefave të Mbrojtjes, e cila u organizua nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, kishte temë shqyrtimi: "Ndërveprueshmërinë në Evropë". Me theks të veçantë në konferencë u diskutua ndërveprueshmëria si koncept si dhe aspektet e gatishmërisë në nivel kombëtar dhe në Aleancën Veri-Atlantike për t'u ballafaquar me kërcënimet dhe rreziqet në Evropë. FSK- ja është dhe mbetet e përkushtuar në mbajtjen e aftësive dhe zhvillimin profesional në të gjitha fushat me qëllim të ndërveprimit me partnerët strategjikë dhe shtetet tjera partnere.



FSK-ja në konferencën Karta e Adriatikut A-5, në Mal të Zi



Në Podgoricë, nën kryesimin e Malit të Zi, u mbajt takimi i drejtorëve për Politikat e Mbrojtjes të Kartës së Adriatikut A5. Në këtë takim morën pjesë të gjithë drejtorët e shteteve rajonale të Ministrive të Mbrojtës, përfshirë edhe përfaqësuesen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kurse nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës mori pjesëFaruk Geci, drejtor për Politika dhe Plane. Temat kryesore që u diskutua gjatë konferencës ishin: E ardhmja e Kartës së Adriatikut-A5, hapat përpara, si dhe kontributi i Kartës së Adriatikut A5 në sigurinë rajonale dhe globale. Vlen të cekët se në këtë takim u përkrahë edhe anëtarësimi i Kosovës në Kartën e Adriatikut A5, si dhe tranzicioni gradual i FSK-së, në mision të ri.

FSK-ja fitoi Medaljen e bronztë në garën e patrullimit „Cambrian Patrol“ në Mbretërinë e Bashkuar

Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht ekipi i përzgjedhur i FSK-së i udhëhequr nga togeri Behar Fazliu, oficer në Batalionin e Dytë të Reagimit të Shpejtë, arriti të fitojë Medaljen e bronztë në garën ndërkombëtare të patrullimit në Uells, garë kjo e rreptë dhe me konkurrencë të fortë prej 137 ekipeve, prej tyre 37 ekipe të ushtrive ndërkombëtare.

Të gjitha ekipet pjesëmarrëse në garë, filluan realizimin e skenarit të stërvitjes nga data 12 tetor, duke u përballur me vështirësitë e mëdha të motit që shkaktoi stuhia ,,Cullum'' edhe në zonën e garës patrulluese. Në këtë garë, ekipi i FSK-së përshkoi një sfidë lundrimi me gjatësi prej 80 kilometrash, përmes një sërë skenarësh të dizajnuar për të testuar udhëheqjen, punën ekipore dhe durimin fizik dhe mendor të ekipit. Përveç Kosovës, në garën morën pjesë edhe ekipet e Forcave të Armatosura të vendeve të rajonit si ato nga Shqipëria, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.

Ushtrimi “Cambrian Patrol“ është një ngjarje vjetore e organizuar dhe e drejtuar nga Brigada e 160-të e Këmbësorisë nga Uellsi, me seli në Breçon. Ky ushtrim është unik, i nivelit botëror dhe më i madhi i këtij lloji, me pjesëmarrje edhe të shteteve të tjera që kanë të drejtë të marrin pjesë në Mbretërinë e Bashkuar, duke fituar nëpërmjet konkurrimit të tyre të brendshëm. Ushtrimi “Cambrian Patrol” teston të gjitha aftësitë themelore ushtarake të një ushtari të sotëm, duke rritur aftësinë e udhëheqjes dhe nivelet e qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë.



Oficeri Naim Zyberaj nderohet me dy çmime në shkollën ushtarake në SHBA



Pjesëtarët e FSK-së, kudo që po marrin pjesë në trajnime dhe shkollime jashtë vendit, po shënojnë rezultate të shkëlqyeshme. Njëri ndër ta është kapiteni Naim Zyberaj, zv. komandant i Kompanisë së Policisë Ushtarake të FSK-së, i cili ka përfunduar me sukses trajnimin 22 javor, “Kursi për kapiten të karrierës për Polici Ushtarake, në shkollën e Policisë Ushtarake në Fort LeonardWood, Missouri. Kapiten Zyberaj, gjatë shkollimit 22 javor në shkollën e Policisë Ushtarake në SHBA, është nderuar me çmimin “Student nderi” për paraqitje akademike të dalluar, kurse për rezultate të shkëlqyera në testin fizik ka marr çmimin “Njeriu i hekurt”. Kursi për kapiten të karrierës përfshin përgatitjen e përgjithshme të oficerëve në fushën e Policisë Ushtarake, në aftësi udhëheqëse, teknike dhe taktike luftarake, në etikë ushtarake, në katër kompetencat e Policisë Ushtarake të zhvillimit të mendimit kritik në procesin e vendimmarrjes ushtarake, udhëheqje, punë grupore etj. Shkollimin në të njëjtën shkollë e kanë përfunduar me sukses edhe dy pjesëtarë të tjerë të FSK-së.

Në Akademinë e Mbrojtjes në Shkup diplomoi edhe një oficer i FSK-së nga radhët e komuniteteve



Më 19 tetor 2018, në Akademinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, ka diplomuar një oficer si dhe ka filluar studimet një kadet i ri i FSK-së, në këtë Akademi, për katër vitet e ardhshme. Një ceremoni solemne, gjithashtu u zhvillua edhe në ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup, ku të dy pjesëtarët e FSK-së dhanë betimin për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, krahas edhe oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së, në njësitë dhe repartet tona. Në ceremoninë e diplomimit në Akademinë e Mbrojtjes në Shkup, sot ishin të pranishëm edhe një delegacion i Forcës së Sigurisë të Kosovës, në krye me gjeneral brigade Nazmi Brahimaj drejtor i Departamentit për Operacione dhe Trajnime në MFSK, i cili shoqërohej edhe nga kolonel Ilir Shyti, shef i Departamentit të Personalit në Komandën e Forcave Tokësore, zonja LejlaLjoci, shefe e Zyrës për Komunitete në MFSK, si dhe major Vegim Kelani, komandant i Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Sipas marrëveshjes bilaterale në mes të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Maqedonisë, kadetët e FSK-së, nga radhët e komuniteteve shkollohen në Akademinë e Mbrojtjes të Maqedonisë dhe më pas vijojnë gjithashtu kursin për integrimin e oficerëve në FSK, në mënyrë që njohuritë akademike dhe ushtarake të unifikohen dhe të jenë të gatshëm për shërbim në detyrën e caktuar nga zingjiri komandues.

Komandanti i FSK-së mori pjesë në konferencën vjetore „Karta e Adriatikut A5”

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahma Rama mori pjesë në takimin vjetor të shefave të Mbrojtjes në kuadër të „Kartës së Adriatikut A-5”, që u mbajt në Budva, Mali i Zi, nga data 3 deri më datën 5 tetor 2018.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, në adresimin e tij në kuadër të konferencës „SHBA-Karta e Adriatikut A5”, i njoftoi homologët e tij lidhur me tranzicionin e FSK-së dhe zgjerimin e kompetencave të saj. Gjeneral Rama me theks të veçantë foli për nevojën e zgjerimit të bashkëpunimit në nivel rajonal; me qëllim të rritjes së ndërveprueshmërisë, besimit dhe shkëmbimit të përvojave në sektorin e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Komandanti i FSK-së gjenerali Rrahman Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneral majoriTimothyOrrzhvilluan një takim të përbashkët me zv. komandantin e Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropëgjenerallejtënant Twitty, ku së bashku diskutuan për marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe. Me këtë rast, gjeneral Rama e njoftoi gjeneralin Twitty lidhur me procesin e tranzicionit, zhvillimin profesional të FSK-së, integrimin e komunitetit joshumicë, bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Gardën Kombëtare të Ajovës-SHBA, si dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet FSK-ja.



Gjenerali Rrahman Rama, gjithashtu zhvilloi takime edhe me shefat e Mbrojtjes të Kroacisë, të Republikës së Maqedonisë dhe të Malit të Zi, dhe së bashku u pajtuan që në të ardhmen ta rrisin bashkëpunimin dypalësh në shkëmbimin e përvojave.

Ministri Rrustem Berisha pjesë e ceremonisë të inaugurimit të Kompleksit Memorial të Heronjve në Marinë



Nën patronatin e kryeministrit të Kosovës RamushHaradinajt dhe kryetarit të Komunës së Skenderajt Bekim Jasharit, më 5 tetor, në Marinë, Skenderaj, u mbajt ceremonia e inaugurimit të Kompleksit Memorial të Heronjve dhe Dëshmorëve të Kombit. Në ceremoni morën pjesë: presidenti Hashim Thaçi, kryetari i Parlamentit KadriVeseli, kryeministri RamushHaradinaj, ministri i FSK-së, Rustem Berisha, njëherësh kryetar i Këshillit Organizativ Qeveritar, gjeneralët: Gëzim Hazrolli, Enver Cikaqi, Fadil Hadërgjonaj dhe Xhevahir Geci, Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane, drejtorë të drejtorive të Ministrisë së FSK-së, oficerë madhorë, nënoficerë, Togu Ceremonial i FSK-së, ushtarë dhe familjarë të dëshmorëve dhe qytetarë të shumtë.

FSK-ja ka bartur dhe rivarrosur trupat e të gjithë dëshmorëve, nga Polaci në Marinë, me nderime ushtarake. Në ceremoninë e inaugurimit të Kompleksit Memorial, kryetari i Skenderajt Bekim Jashari, në mënyrë të veçantë ka falënderuar ministrinë e FSK-së dhe FSK-në për punën e madhe, respektin dhe madhështinë që i kanë dhënë këtij aktiviteti dhe kësaj ceremonie.

Ndërkaq, presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, i ka dekoruar të gjithë dëshmorët e varrosur në Marinë me urdhrin „HERONJË TË KOMBIT”. Në manifestim folën edhe kryetari i Kuvendit KadriVeseli, kryeministri Haradinaj, kryetari i veteranëve HysniNgucati dhe kryetari i DrenasitRamizLadrovci.

Pas fjalimeve, nga Togu Ceremonial i FSK-së është bërë rivarrimi i Heronjve të Kombit, Ilaz Kodra, komandant i Brigadës 114 ”FehmiLladrovci”, Mujë Krasniqi, komandant i Brigadës 113 që mban emrin e tij dhe AbedinRexha, komandant i Brigadës 112 “Arben Haliti”. Manifestimi u mbyll me një monolog për dëshmorët të interpretuar nga aktori i mirënjohur BasriLushtaku.

Përfundoi me sukses ushtrimi i përbashkët „SILVER SABRE 2018-2”

FSK-ja ka marrë pjesë në Ushtrimin Vend Komandë (UVK) „SILVER SABRE 2018-2”, i cili u realizuar në kampin e KFOR-it, Film City si dhe në Komandën e Forcave Tokësore (KFT) në Prishtinë, prej datës 11-19 tetor 2018 (në aktivitete të ndara sipas konceptit të operacionit), me qëllim të operimit të përbashkët me institucionet dhe autoritet e sigurisë vendore dhe ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Ushtrimi u përcoll nga stafi i lartë i MFSK/FSK-së. Qëllimi i këtij ushtrimi është ngritja e vazhdueshme e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me KFOR-in dhe me agjencitë tjera të sigurisë në Republikën e Kosovës, në funksion të ruajtjes së aftësive në standardin më të mirë të mundshëm. Ky ushtrim ka për qëllim koordinimin ndërinstitucional si dhe familjarizimin me procedurat në menaxhimin e incidenteve të shkallës më të lartë, kryesisht menaxhimin e situatave pas deklarimit të gjendjes emergjente të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore.

Roli i FSK-së në UVK “SILVER SABRE 2018-2” është angazhimi i trupave me qëllim të asistimit të autoritetet qendrore në aplikimin e Planit të Reagimit Kombëtar, me anë të të cilit përcaktohen reaguesit e parë, të dytë dhe të tretë. FSK/KFT-ja gjatë UVK-së „SILVER SABRE–18-2” është angazhuar me 8 pjesëtarë në Kontrollin e lartë dhe Kontrollin e ulët, në „FILM CITY”, gjithashtu me dy oficerë ndërlidhës në Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë Kombëtare (KSK), si dhe i tërë shtabi i KFT-së. Gjenerali Enver Cikaqi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e ushtrimit të cilët dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm, për 40 orë



rresht, duke treguar gatishmëri dhe paraqitje të mirë në demonstrimin e aftësive në një ambient shumëkombësh.

Kontingjenti i FSK-së përfundoi me sukses ushtrimin fushor “SaberJunction 2018” në Gjermani



Një kontingjent i FSK-së, nga data 12 shtator deri më 01 tetor 2018, mori pjesë në ushtrimin fushor “SaberJunction 2018”të mbajtur në Hohenfels, Gjermani. Kontingjenti përbehej nga 10 pjesëtarë të Policisë së Forcës dhe 2 vlerësues/kontrollues. Kontingjenti i FSK-së i është bashkangjitur Kompanisë Pranë Shtabore të Batalionit të 54-të të Xhenios (54 th BEB) në Grafenëohr, në fazën e planifikimit dhe përgatitjes për zhvillimin e operacionit përfundimtar, luftimit Forcë me Forcë, kurse vlerësuesit/kontrolluesit kanë vazhduar trajnimin në Akademinë për Vlerësues/Kontrollues. Kontingjenti i FSK-së së bashku me njësitë tjera kanë kryer këto aktivitete: ndërtimin e pikës së grumbullimit për të ndaluarit e luftës; organizimi, funksionimi, trajtimi i tyre, përcjellja e konvojëve, pikat e kontrollit, ofrimi i sigurisë fizike, perimetri i sigurisë, kontrollimi i personelit dhe evakuimi i civilëve nga fushëbeteja.

Tetarit Arian Ramadani, nga ekipi vlerësues/kontrollues, i është ndarë “Certifikata e Arritshmerisë”, kurse tetari Petrit Qollaku u nderua me çmimin “Hero i Hohenfelsit”, për angazhim, gatishmëri, përformancë dhe aftësi të dalluara gjatë ushtrimit fushor. Ushtrimi u organizua nga Komanda e 7-të e trajnimit të ushtrisë në Qendrën e Bashkuar Shumëkombëshe të Gatishmërisë në Hohenfels, dhe ishte dizajnuar që të vlerësojë gatishmërinë e Brigadës 173 të Këmbësorisë Luftarake (Airborne), gjatë zhvillimit të operacioneve tokësore në një ambient të kombinuar, si dhe të promovojë bashkëveprimin me 20 shtetet aleate dhe partnere. Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë rreth 5500 pjesëtarë dhe njësi të ndryshme.

Kontingjenti i FSK-së është vlerësuar për motivin e lartë, disiplinën dhe gatishmërinë e treguar gjatë gjithë kohës së realizimit të ushtrimin fushor “SaberJunction 2018”.

FSK-ja realizoi projektin humanitar në fshatin Gjurgjevik të Madh të Klinës



Ministri Rrustem Berisha tha se Mbështetja e FSK-së në këtë projekt për banorët e Gjurgjevikut është dëshmia më e mirë se FSK-ja është e të gjithëve dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit. Më 16 tetor në fshatin Gjurgjevik i Madh, Komuna e Klinës, FSK-ja filloi realizimin e projektit humanitar për zgjerimin dhe rrafshimin e rrugës Gjurgjevik i Madh-Dobërdol në gjatësi prej 4 kilometrash. Me rastin e fillimit të punimeve ishin të pranishëm ministri i FSK-së Rrustem Berisha, ministri i Infrastrukturës Pal Lekaj, kryetari i Komunës së Klinës ZenunElezaj, gjeneral brigade Naim Haziri, si dhe përfaqësues të fshatit Gjurgjevik.

Fillimin e realizimit të projektit humanitar e përshëndeti ministri i FSK-së Rrustem Berisha, i cili veç të tjerash tha: „Ne, si Forcë e Sigurisë së Kosovës po dëshmojmë çdo herë se jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Edhe ndërtimi i kësaj rruge sot, e cila do t’ua lehtësojë lëvizjen banorëve të kësaj ane, në bashkëpunim me Komunën e Klinës dhe Ministrinë e Infrastrukturës, është dëshmia më e mirë se jemi në shërbim të qytetarëve të Kosovës”,-përfundoi fjalën e tij ministri Berisha. Ndërsa, ministri i Infrastrukturës Pal Lekaj, dhe kryetari i Komunës së Klinës ZenunElezajkanë falënderuar FSK-në dhe ministrin Berisha për realizimin e këtij projekti me rëndësi për banorët e kësaj ane. Në fund, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale gjeneral brigade Naim Haziri, i përgëzoi pjesëtarët e Batalionit të Xhenios për ndërtimin e kësaj rruge.

Afrim Hysenaj i dhuroi FSK-së monografinë për masakrën e Deliajve



Bibliotekës së FSK-së, më 19 tetor, iu shtua edhe një botim i ri, nga ish-pjesëtari i FSK-së, Afrim Hysenaj, monografia kushtuar masakrës së Deliajve me titull „Toka skuq e qielli nxin”. Afrim Hysenaj, ish-oficer i Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe i Forcës së Sigurisë të Kosovës, për 20 vjet rresht ka kryer shumë detyra dhe kurse të avancuara në aspektin profesional si brenda institucioneve ashtu edhe me forcat e KFOR-it. Gjatë viteve 2009-2016 ka përfunduar studimet universitare për Bachelor dhe Master në drejtimin e Sociologjisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Afrimi ka të botuar punimin shkencor me titull “Dukuria e divorceve në Kosovë” si dhe tani ka botuar monografinë për masakrën e Deliajve me titull „Toka skuq e qielli nxin”.

Gjestin humanitar të Afrim Hysenajt, të dhurimit të librave për Bibliotekën e FSK-së, e përshëndeti edhe komandanti i NJRK-së, nënkoloneli MilaimMusliu. “Kjo ndihmë ka një rëndësie të veçantë për ne, kur dihet se krijuesi Afrim Hysenaj, ishte edhe vetë pjesëtarë i FSK-së. Librat janë të çmuar për të gjithë ne, sidomos librat e këtij lloj si monografia „Toka skuq e qielli nxin”.

„Edhe, në këto momente po e ndiej vetën si pjesë e FSK-së”, tha fillimisht Afrim Hysenaj, Jam shumë i emocionuar, por edhe i nderuar, që pata mundësinë që librin tim, t’ia dhuroi Bibliotekës së FSK-së, kolegëve të mi, kadetëve, ushtarëve dhe studentëve, që do të kenë mundësi të pajisen me dije. Biblioteka është simbol i punës dhe dijes dhe secili nga ne, duhet ta ndihmojmë”. Afrimi premtoi se edhe botimet e librave të tjerë së pari do t’ia dhuroi Bibliotekës së FSK-së.

Pjesëtarët e Kërkim-Shpëtimit të FSK-së certifikohen në tri kurse





Kursin e Mbrojtjes Kimike Atomike dhe Biologjike

Në Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, më 1 tetor, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së në tri kurse. 6 pjesëtarë nga BRSH-ja dhe 3 nga MKAB-ja, dy prej tyre nga komuniteti serb, janë certifikuar në trajnimin bazik për MKAB. Pjesëtarët e këtij kursi janë trajnuar në dy sferat e parapara sipas planit, në aspektin teorik dhe praktik, duke zhvilluar temat si: Detektimi dhe tërë procesi i dekontaminimit, puna në ekip në procesin e vendincidentit, marrja e mostrave, ndalja dhe kapja e rrjedhjes së bashku me procedurat bazike të radioaktivitetit etj.

Kursin e kërkim-shpëtimit në ujëra dhe atë urban

Po ashtu 8 pjesëtarë të FSK-së, kanë përfunduar me sukses Kursin e avancuar për kërkim-shpëtim urban dhe 15 pjesëtarë të FSK-së Kursin për mbijetesë në ujë. Udhëheqësi i Kursit të avancuar për kërkim–shpëtim urban, OR5 Sabri Sada u shpreh: "Pjesëtarët e Kursit të avancuar për kërkim-shpëtim urban gjatë kursit janë njohur me metodat e avancuara të K-SH-së Urbane, në veçanti nëpër objekte të rrënuara si pasojë e tërmeteve, dhe janë kualifikuar si pjesëtarë senior të K-SH-Urbane. Me këtë, rritet edhe përgjegjësia e mbikëqyrjes së punës së anëtarëve të rijnë të ekipit. Faza tjetër e trajnimit për senior të K-SH-së Urbane do të zhvillohet vitin e ardhshëm". Ndërsa, udhëheqësi i Kursit për mbijetesë në ujë, OR-7 kapter EkremTernava, lidhur me kursin që ai drejtoi tha: "Ky kurs ishte një testues fizik dhe mental, ku studentët jo vetëm që është dashur të veprojnë në ambiente ujore të ndotura, por gjithashtu është dashur të ballafaqohen edhe me temperatura të ulëta, që kanë mbizotëruar ditën dhe natën, gjatë zhvillimit të ushtrimeve. Për disa nga pjesëtarët e kursit, kjo ishte një përvojë e parë dhe e veçantë. Ata pas përfundimit të këtij kursi, janë pajisur me një bagazh të gjerë të aftësive për të shpëtuar jetë njerëzish. Në fund, komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri, nënkoloneli Bajram Bekteshi dhe instruktorët e Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, për të gjithë pjesëmarrësit e kurseve u ndanë certifikata. Vlen të ceket se, kjo ceremoni ishte më e veçantë pasi që përkoi edhe me përvjetorin e dytë të hapjes zyrtare të Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim.



Certifikohen 40 pjesëtarë të FSK-së dhe të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave të Kosovës

Pas një trajnimi katër-ditor në kursin "Kujdesi taktik i traumave apo i të lënduarve" nga instruktorët e DefenceThreatReductionAgency (DTRA) të SHBA-ve, më 26 tetor, në kazermën e Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, u certifikuan 40 pjesëmarrës, 20 të FSK-së dhe 20 të Agjencisë së Emergjencave të Kosovës. FSK-ja gjatë viteve të fundit ka marrë trajnime të drejtpërdrejta mjekësore në nivele të ndryshme nga instruktorët e SHBA-ve. Edhe trajnimi "Kujdesi taktik i traumave apo i të lënduarve" është realizuar, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Ambasadën Amerikane në Kosovë, në dy fusha; në pjesën teorike dhe atë praktike në terren, përmes improvizimeve të rasteve të ndryshme emergjente. Komandanti i Forcave Tokësore gjenerali Enver Cikaqi, me një fjalë rasti, në ceremoni, u shpreh: "Falënderoj ekipin e DTRA-s për angazhimin e tyre, të cilët nuk po kursejnë kohën dhe mundin që t'i trajnojnë pjesëtarët tanë dhe të agjencive të tjera të sigurisë në Kosovë, prandaj në emrin tim dhe në emër të FSK-së, ju shpreh falënderime miqve tanë amerikanë, për gatishmërinë e vazhdueshme për ta ndihmuar FSK-në. Të gjitha objektivat e këtij kursi tregojnë qartazi se sa i rëndësishëm ka qenë ky trajnim për ne". Po ashtu gjeneral Cikaqi ju drejtua edhe pjesëtarëve të FSK-së dhe atyre të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave me këto fjalë: "Ne jemi mjaft të kënaqur me motivimin tuaj gjatë këtij kursi, ku jeni pajisur me njohuri rreth procedurave të ndihmës së parë dhe dhënies së saj në situata të ndryshme, prandaj ju përgëzojë për përfundimin me sukses të këtij trajnimi. Njëherësh falënderoj instruktorët e DTRA-s për punën e mirë që kanë bërë gjatë këtij trajnimi".



Ndërkaq, majori Kalun-Schmidt nga DTRA, vlerësoi lart gatishmërinë, vullnetin, angazhimin dhe përkushtimin e pjesëtarëve të FSK-së dhe të Agjencisë së Emergjencave të Kosovës gjatë trajnimit. „Ky trajnim do të thellohet dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ju jeni trajnuar ashtu siç trajnohen ushtarët tanë që hyjnë në fushëbeteja. Besoj se ky trajnim do të ju ndihmojë edhe në jetën e përditshme". Bazuar në vlerësimin e instruktorëve, ushtari Ukshin-Hajdari është shpallur student më i dalluar i këtij kursi, i cili nga ta është shpërblyer me medalje. Ndërkaq, edhe gjeneral Enver Cikaqi në shenjë respekti ka ndarë mirënjohje për instruktorët amerikanë.

FORCA JONË

Viti VII • Nr. 74 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

FSK KREDIBILE, PËRFAQËSUESE DHE E GATSHME!



Prishtinë, 27 Nëntor 2018

FORCA JONË

Viti VII • Nr. 74 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti i VII • Nr. 74 • Edicioni festiv • Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun,
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Adresa: MFSK, Kazerma ,,Adem Jashari'', Prishtinë

Adresa elektronike: informimi.mfsk@gmail.com, informimi.mfsk@rks-gov.net

Tel: 038/551-379

www.mksf-ks.org





Viti i zhvillimeve pozitive për FSK-në dhe Kosovën

Me kënaqësi mund të konstatojmë se ky vit kalendarik, ishte vit i zhvillimeve pozitive në FSK, të cilat e përgatitën Forcën për një tranzicion të suksesshëm. Krahas mbajtjes dhe avancimit të kapaciteteve për misionin aktual, në mbështetje të institucioneve civile përkatësisht komuniteteve, si MFSK dhe Forcë, gjatë këtij viti kemi intensifikuar bashkëpunimin tonë si, në nivel rajonal, me partneret tanë strategjik dhe qendrat e vendosjes së NATO-s.

Përmes vizitave dhe takimeve informuese, kemi arritur të marrim përkrahje dhe konfirmim për të drejtën e Kosovës për tranzicionin e FSK-së. Kemi marrë obligime që ky proces të jetë gradual, transparent, gjithëpërfshirës dhe në harmoni me ligjet dhe kushtetutën e vendit. Ne i kemi siguruar partnerët tanë, se mandati i ri i FSK-së do të ruaj karakterin profesional, me mision mbrojtës si dhe përfaqësimin e diversitetit etnik në Kosovë. Jemi zotuar se rajoni do të ketë edhe një forcë aleate, të bashkëveprueshme në shërbim te krijimit dhe ruajtjes së paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon dhe me gjerë.

Procesi i tranzicionit është si rezultat i stadit profesional në të cilin ka avancuar Forca e Sigurisë së Kosovës dhe që e benë të gatshme për të marrë përgjegjësi të reja në fushën e mbrojtjes. Dedikim i veçantë është për Praninë Ushtarake Ndërkombëtare në vend, me theks të posaçëm për stafin e Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NALT), të cilët na kanë ndihmuar në baza ditore në tërë këtë proces.

Nuk ka dyshim se SHBA-të janë promotorë i ecjes tonë të sigurt drejt synimit për të krijuar kapacitetet mbrojtëse të Kosovës, si elementi përmbyllës i procesit të shtet ndërtimit të Kosovës. Kjo komponentë shtetërore, Kosovën do ta bëj një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët e saj. Prandaj mirënjohje veçantë për ShBA e cila do të jetë në partneritet të përhershëm si; në raportet e mbrojtjes dhe ato ndërshtetërore.

Sukseset e FSK-së në përmbushjen e misionit të sajë, rezultatet në bashkëpunimin bilateral me vendet mike dhe partnere të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë, rezultatet në edukimin dhe zhvillimin e kuadrove, sukseset në ushtrime të përbashkëta me vendet e rajonit dhe anëtare të NATO-s, kanë bërë që FSK-ja të ketë edhe mbështetjen unanime të spektrit politik në vend. Kjo u tregua më së miri, me votim të shumicës absolute të të gjithë deputetëve të Parlamentit të Kosovës, për kalimin në lexim të parë të bazës ligjore, për tranzicionin dhe mandatin e ri të FSK-së. Ky vit na vendos para objektivave që janë esencial për ndërtimin e sistemit të mbrojtjes dhe sigurisë siç janë, raporti me NATO-n, orientimi drejt integrimeve në nismat rajonale dhe euroatlantike te sigurisë.

Meritor që FSK-ja të jetë institucioni më i mbështetur në vend, janë stafi i oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve, stafi civil, puna dhe përkushtimi profesional i të gjithëve.

Edhe një herë duke falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë në sukseset e FSK-së, ju uroj Ditën e Forcës.

Rrustem Berisha,
Ministër për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Viti i ndryshimit të madh për FSK-në



Sot, duke reflektuar për të arriturat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndjehem krenar dhe i privilegjuar të komandoj dhe drejtoj vajzat dhe djemtë më të mirë të këtij vendi. Besueshmëria, gjithëpërfshirja dhe gatishmëria, karakterizojnë vitin që do të mbetet në historinë e re të Kosovës, për faktin e ndryshimit të misionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ndërtimin gradual të aftësive të reja për mbrojtje të integritetit territorial.

Besueshmëria e Forcës qëndron në shpirtin e ekipit dhe edukimin profesional të gjeneratave të reja. Shkollimet dhe ushtrimet brenda dhe jashtë vendit kanë rritur ndërveprueshmërinë me partnerët tanë, duke ndërtuar njëkohësisht besimin në mes të FSK-së dhe partnerëve. FSK-ja ishte dhe mbetet e përkushtuar për të mbështetur autoritetet civile dhe për të ndihmuar qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim. Besueshmëria jonë është rritur falë përkushtimit tonë në operacione reale dhe punës së palodhshme të ekipeve të Deminimit, Kërkim Shpëtimit, Mbrojtjes Kimike, Xhenios dhe Mjekësisë, pa harruar dhe ekipet e BRSH-së, që na bënë krenarë në të gjitha aktivitetet kolektive brenda dhe jashtë vendit. E tërë kjo ndërmarrje e njerëzve të devotshëm dhe me karakter të lartë, po krijon ura mirëbesimi dhe po vendos themelet e orientimit tonë strategjik drejt integrimit në NATO.

Gjatë këtij viti, vizioni ynë kishte për qëllim ndërtimin e organizatës gjithëpërfshirëse, ku diversiteti përbën vlerën themelore mbi bazën e së cilës trajtohen njerëzit në mënyrë të barabartë. Kjo vlerë është burim i vazhdueshëm shprese për një të ardhme më të mirë. Por ky progres, kjo vlerë dhe përkushtim i FSK-së është duke iu penguar qarqeve të ndryshme jashtë vendit. Përdorimi i presionit dhe mënyrave të shekullit të kaluar mbi pjesëtarët tanë të komunitetit serb gjatë këtij viti, janë të shëmtuara dhe në kundërshtim me çdo parim demokratik. FSK-ja është institucion që drejtohet dhe operon mbi bazën e vlerave dhe parimeve më të larta, ku qytetarët trajtohen njësoj, ku e ardhmja është shpresë dhe ku dinjiteti njerëzor është parim.

Është fakt i padiskutueshëm që FSK-ja është dhe jemi të bindur se do të mbetet institucioni me gatishmërinë më të lartë në vend.

Dislokimet jashtë vendit, ushtrimi fushor "Shqiponja 6", ishin aktivitete me intensitet dhe gatishmëri të lartë për të operuar, rritur ndërveprueshmërinë dhe për të kontribuar në sigurinë dhe paqen në rajon dhe më gjerë. KDS-ja gjatë kësaj faze ka luajtur një rol kyç në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, duke dëshmuar se ka kapacitete dhe infrastrukturë moderne për realizimin e trajnimeve institucionale. Edhe përkundër procesit të tranzicionit, ne ju sigurojmë që do të jemi në gatishmëri të plotë për të mbështetur dhe ofruar ekspertizën tonë në të mirë të vendit dhe qytetarëve.

Gjatë këtij viti, të dashur ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, vëmendja dhe përpjekjet e mia kanë qenë të orientuara në krijimin e kushteve për tranzicion. Ishte vit me një intensitet jashtëzakonisht të lartë në koordinimin kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim të sinkronizimit të përpjekjeve tona për ndryshimin e misionit të FSK-së. Andaj, unë vetëm kam përfaqësuar zërin tuaj profesional që me sukseset e juaja i keni bërë të mburren të gjithë qytetarët e Kosovës.

Duke ju uruar Festën, Ju uroj për detyrat dhe përgjegjësitë e reja. Kjo na motivon dhe na jep shpresë për një të ardhme më të mirë. Forca e Sigurisë së Kosovës, vazhdon të jetë model për të gjitha institucionet e vendit, si dhe model për të gjitha institucionet ushtarake në rajon dhe më gjerë.

Njëkohësisht, në emrin Tuaj dua t'i falënderoj publikisht miqtë tanë, SHBA-të, NALT/NATO-n dhe vendet tjera që na kanë ndihmuar, këshilluar dhe mbështetur në rrugëtimin tonë. E ardhmja jonë është në partneritet dhe besim të plotë me vendet anëtare të NATO-s, KFOR-in dhe në veçanti me partneritetin tonë ndërshtetëror me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Uroj gjithë të mirat për Ju dhe familjet Tuaja!

Gjenerallejtënant Rrahman Rama

Projektligjet për transformimin e MFSK-së dhe FSK-së miratohen unanimisht në Qeverinë e Republikës së Kosovës



Në mbledhjen e sotme të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me votë unanime të kabinetit qeveritar, u miratuan tri ligjet bazë për transformim të FSK-së me mision dhe detyra shtesë: Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes. Në mbledhjen e Qeverisë së vendit, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës z. Rrustem Berisha, paraqiti ekspozenë ku ka argumentuar arsyetimin për procedim dhe miratim të Pakos së projektligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilat u miratuan nga kabineti qeveritar i Republikës së Kosovës.

Në vazhdim gjeni ekspozenë e plotë të ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, të mbajtur në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 13shtator 2018.


Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës votuan në lexim të parë tri projektligjet për MFSK-në dhe FSK-në

Pas rezymeve të ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Rrustem Berisha, për tri projektligjetpër Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës / Forcën e Sigurisë së Kosovës, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, votuan në lexim të parë: Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ekspozetë e ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovë z. Rrustem Berisha, para deputetëve të



Kuvendit të Republikës së Kosovës për tri projektligjet.

Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi ka graduar dhe emëruar gjeneralët e FSK-së



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaqi, në cilësinë e Komandantit Suprem të FSK-së dhe të kompetencave kushtetuese që ka, në koordinim me ministrin dhe komandantin e FSK-së, në prani të ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës zotit Rrustem Berisha dhe komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka bërë gradimet dhe emërimet e gjeneralëve të FSK-së. Presidenti Hashim Thaqi ka graduar gjeneral brigade Bashkim Jasharin në gjeneralmajor, po ashtu ka graduar gjeneral brigade Zymer Halimin në gjeneralmajor. Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli është graduar ne gjeneralmajor dhe është emëruar drejtor i Drejtorisë së Operacioneve në MFSK. Presidenti Thaqi ka emëruar gjeneral brigade Enver Cikaqin komandant të Komandës së Forcës Tokësore të FSK-së. Kolonel Irfete Spahiun e ka graduar në gradën gjeneral brigade dhe po ashtu e ka emëruar komandant të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Kolonel Naim Hazirin e ka graduar në gjeneral brigade dhe e ka emëruar komandant të Brigadës për Mbështetje Operacionale. Kolonel Xhevahir Gecin e ka graduar në gjeneral brigade dhe e ka emëruar zëvendëskomandant të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së. Kolonel Fadil Hadërgjonajn e ka graduar gjeneral brigade dhe ka emëruar oficer Shtabi i kabinetit të ministrit të FSK-së. Kolonel Skender Zhitin e ka graduar gjeneral brigade dhe e ka emëruar shef të Departamentit të Personelit në MFSK. Me gradimin e kolonel Irfete Spahiut në gradën gjeneral brigade, FSK-ja bëhet me femrën e parë që bartë gradën e gjeneralit, kurse gjeneral brigade Irfete Spahiu nga sot është oficerja e parë e FSK-së që bartë këtë gradë.

Ministri i FSK-së priti në vizitë ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, z. Rrustem Berisha, priti në vizitë zyrtare në ambientet e MFSK-së ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi, z. Predrag Boshkoviç. Ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi z. Boshkoviç u prit më nderime të larta nga Togu Ceremonial dhe Orkestra Frymore e FSK-së.Ministri Berisha dhe ministri Boshkoviç së pari zhvilluan një takim kokë më kokë, për të vazhduar më pastaj me një takim të përbashkët të dy delegacioneve. Ministri Berisha pasi i dëshiroi mirëseardhje ministrit Boshkoviç, e njohu atë edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, ngritjen profesionale dhe procesin e tranzicionit të FSK-së. Gjatë takimit, të dy ministrat biseduan edhe për bashkëpunimin e deritashëm, marrëdhëniet e mira dypalëshe, vazhdimin e bashkëpunimi në të ardhmen si dhe për mbështetjen reciproke të bazuar në memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive.

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha priti ministren e Mbrojtjes të Maqedonisë Radmilla Shekerinska



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, priti në vizitë me ceremoni zyrtare ministren e Mbrojtjes të Maqedonisë, znj. Radmilla Shekerinska-Jankovska.

Së pari të dy ministrat zhvilluan një takim kokë më kokë dhe më pas një takim të zgjeruar me të dy delegacionet. Ata biseduan për marrëdhëniet e mira dypalëshe, aktivitete konkrete si dhe vazhdimin e këtyre marrëdhënieve edhe në të ardhmen.Me këtë rast, ministri Berisha falënderoi ministren Shekerinska për bashkëpunimin e mirë dhe konkret me Ministrinë që ajo drejton, për gatishmërinë për zgjerimin e fushave të bashkëpunimit, si dhe për shkëmbimet e tjera në fushën e trajnimeve, shkollimeve dhe ushtrimeve fushore.Ministri Berisha në këtë takimpohoi aspiratën e Republikës së Kosovës për anëtarësim në NATO dhe integrim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se marrëdhëniet e mira me vendet anëtare të NATO-s dhe vendet që aspirojnë për t'u anëtarësuar në NATO është prioriteti ynë.

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha priti në vizitë ministren e Mbrojtjes të Francës, znj. Genevieve Darrieussecq



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Rrustem Berisha priti në një vizitë zyrtare me ceremoni ushtarake ministren e Mbrojtjes të Francës, znj. Genevieve Darrieussecq.

Ministri Berisha së bashku me ministren e Francës, znj. Darrieussecq kryesuan edhe takimin e përbashkët të dy delegacioneve, ku biseduan për bashkëpunimin e dyanshëm ndërmjet Kosovës dhe Francës, MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Francës si dhe për zhvillimet në fushën e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Ministri Rrustem Berisha viziton Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Rrustem Berisha u prit më 2 nëntor në Shkup nga ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë, znj. Radmilla Shekerinska. Të dy ministrat në takimin e përbashkët biseduan për zhvillimet në Kosovë e Maqedoni, situatën e sigurisë, bashkëpunimin dypalësh në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes si dhe për hapat që po ndërmarrin të dyja vendet për të qenë së ma afër realizimit të qëllimit për integrime euroatlantike. Gjithashtu biseduan për mundësitë e reja të bashkëpunimit në fusha të ndryshme e me theks të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe atë të sigurisë. Gjatë qëndrimit në Shkup, ministri Berisha u takua



edhe me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, z. Talat Xhaferin.

Ministri Rrustem Berisha u prit me nderime të larta ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes të Kroacisë



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Rrustem Berisha, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Kroacisë, Damir Krstiqevic, qëndroi për vizitë zyrtare në Zagreb. Ministri Berisha dhe ministri Krstiqevic biseduan lidhur me situatën aktuale të sigurisë në të dy vendet, në rajon dhe më gjerë, si dhe për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy shteteve dhe dy ministrive. Ministri Berisha njëherësh e njohu homologun Krstiqevic edhe me zhvillimet aktuale në vend, si dhe me procesin e tranzicionit të FSK-së. Ndërsa, ministri i Kroacisë ri-konfirmoi edhe një herë gatishmërinë e Kroacisë për mbështetjen e gjithanshme të Kosovës.

Ministri Berisha u prit nga presidenti Ilir Meta dhe ministrja Olta Xhaçka





Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, gjatë vizitës në Shqipëri u prit në vizita të ndara presidenti Ilir Meta dhe ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka. Ministri Berisha me presidentin Meta biseduan për marrëdhëniet Kosovë-Shqipëri, situatën në rajon e më gjerë, ndikimin dhe rolin e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s dhe kontribuuese e ruajtjes dhe ndërtimit të paqes përkrah shteteve demokratike, për mundësitë potencialet që ka shteti shqiptar për mbështetjen e Republikës së Kosovës në ndërtimin e kapaciteteve të sigurisë dhe të mbrojtjes, si dhe për mbështetjen e Kosovës në rrugën e saj për anëtarësim në iniciativat dhe organizmat ndërkombëtarë të sigurisë.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, ministri Rrustem Berisha u prit në takim edhe nga ministrja shqiptare e Mbrojtjes z. Olta Xhaçka, më të cilën biseduan për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë si dhe për marrëdhëniet e mira dypalëshe ndërmjet Ministrisë për FSK dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

Vizita e asistentit të Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve Robert Karem në MFSK

Ministri Berisha falënderoi SHBA-të për ndihmën e gjithanshmepër FSK-në, si me angazhim të personelitashtu edhe me bashkëpunimin shumë intensiv dhe të gjithanshëm. Ky bashkëpunim kulmon sidomos me bashkëpunimin që ka FSK-ja me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ministri Berisha foli edhe për standardin e lartë që ka FSK-ja, përgatitjen profesionale si dhe angazhimet e shumta në kryerjen e detyrave me përkushtim në bazë të misionit aktual.Pas 19 vjetëve të çlirimit, 10 vjetëve të shpallje së pavarësisë, si dhe



pas rekomandimeve të dala nga RSSSK, qytetarët dhe institucionet presin përfundimin e procesit të tranzicionit të FSK-së në FAK.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, nga ana tij, theksoi se FSK-ja është forcë profesionale, me koncept perëndimor dhe e mbështetur në konceptet dhe në doktrinën amerikane. Me arritje të larta në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, sidomos me shtetet me të cilat janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe. Ai theksoi edhe përfaqësiminnë përqindje mjaft të mirë të komuniteteve pakicë në FSK.

Komandanti i FSK-së priti në vizitë shefin e Mbrojtjes të Gjermanisë



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në mjediset e ministrisë priti me ceremoni ushtarake shefin e Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë, gjeneral Eberhard Zorn.Gjeneral Rama dhe gjenerali Zorn së bashku me delegacionet e tyre zhvilluan një takim të përbashkët, ku diskutuan për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Gjermanisë dhe Kosovës, përkatësisht Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë.Me këtë rast, komandanti i FSK-së duke e falënderuar shefin e Mbrojtjes së Gjermanisë për kontributin e Gjermanisë në kuadër të KFOR-it, si shtet anëtar i NATO-s, u shpreh se Ministria për FSK dhe FSK-ja, në kuadër të marrëveshjes dypalëshe të bashkëpunimit, kanë marrëdhënie shumë të mira me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë dhe se këto marrëdhënie do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, u shpreh gjeneral Rama.

Shefi i Ushtrisë së Italisë Gjenerallejtënant Salvatore Farina u prit në FSK



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti me ceremoni ushtarake në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Italisë, gjenerallejtënant Salvatore Farina.Ministri Rrustem Berisha, gjeneral Rama, zëvendësministrat Burim Ramadani dhe Agim Çeku, sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj dhe stafi i lartë i MFSK/FSK-së, zhvilluan një takim të përbashkët me delegacionin italian të Forcave të Armatosura, ku përveç kryesuesit të delegacionit, gjeneralit Farina, ishin edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral majori Salvatore Cuoci dhe ambasadori i Italisë në Kosovë, z. Piero Cristoforo Sardi.

Ministri i FSK-së priti zëvendës-asistentin e Sekretarit Gjeneral të NATO-s për çështje operacionale John Manza



Ministri i FSK-së Rrustem Berisha së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, të shoqëruar nga zyrtarë dhe eprorë të lartë të Ministrisë dhe FSK-së, pritën një delegacion të lartë të NATO-s të kryesuar nga z. John Manza, zëvendës- asistent i Sekretarit Gjeneral të NATO-s, i cili ishte i shoqëruar edhe nga zëvendësshefi i Ekipit Këshillues Ndërlidhës i NATO-s (NALT), z Mark Theobald.Ministri Berisha ka vlerësuar lart shkallën e bashkëpunimit të deritashëm me NATO-n, kontributin e NALT-it në MFSK dhe FSK, bashkëpunimin e mirë me KFOR-in, bashkëpunimin e mirë me shtetet fqinje, në veçanti me ato shtete që kemi. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, e njoftoi delegacionin e lartë nga Brukseli me aktivitetet e FSK, sukseset e kadetëve në vende të ndryshme të botës, sukseset e FSK-së në fushat operacionale, nivelin e stërvitjeve me standarde të NATO-s, pjesëmarrjen e FSK-së në trajnime dhe ushtrime fushore ndërkombëtare, përgatitjet për konferencën vjetore të prillit "FSK dhe Partnerët", përgatitjet për mbajtjen e ushtrimit fushor "Shqiponja -6", ku do jenë pjesëmarrëse edhe 12 shtete partnere të Kosovës.

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha, priti në vizitë ministrin e Mbrojtjes të Irlandës Paul Kehoe

Sot, ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Rrustem Berisha priti ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Irlandës, zotin Paul Kehoe. Në takimin e përbashkët në mes të dy delegacioneve, ministri Berisha së bashku me ministrin e Republikës së Irlandës, zotin Kehoe biseduan për bashkëpunimin e dyanshëm në mes të Kosovës dhe Republikës së Irlandës, MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Irlandës si dhe për zhvillimet në fushën e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë.Ministri Rrustem Berisha, ka falënderuar ministrin e Republikës së Irlandës Paul Kehoe për bashkëpunimin e deritashëm dhe për ndihmën që Irlanda ka dhënë dhe po jep për Kosovën, duke e njoftuar me zhvillimet e përgjithshme në Ministri dhe në Forcën e Sigurisë të Kosovës.



Ministri Rrustem Berisha u prit nga Sekretarja e Shtetit pranë Ministrisë së Armatave të Francës znj. Geneviève Darrieussecq



Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, u prit në Paris nga Sekretarja e Shtetit pranë Ministrisë së Armatave të Francës, znj. Geneviève Darrieussecq.Në një takim miqësor u evokuan marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërmjet dy vendeve dhe u bisedua për bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Ministri Berisha e njoftoi ministren franceze për të arriturat dhe synimet e FSK-së, ndërsa znj. Darrieussecq e përgëzoi ministrin për sukseset, sidomos në integrimin e komuniteteve joshumicë. Franca është partner i rëndësishëm i Kosovës dhe vizita e ministrit Berisha bëhet në prag të shënimit të 10- vjetorit të Pavarësisë së Kosovë, për t'i shprehur mirënjohje Francës për kontributin e saj në rrugëtimin e Kosovës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Timothy Orr

Ministri i FSK-së zoti Rrustem Berisha priti sot komandantin e Gardës Kombëtare (GK) të Ajovës, gjeneral major Timothy Orr, i cili shoqërohej nga një delegacion i gjerë civil dhe ushtarak nga Ajova dhe koloneli Jeffrey H. Fisher, atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-ve, në Prishtinë.Ministri Berisha me këtë rast vlerësoi lart shkallën e bashkëpunimit të gjerë dhe intensiv në kuadër të partneritetit ekzistues në mes MFSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, duke thënë se sukseset e arritura të FSK-së janë edhe mëritë e juaja zoti gjeneral dhe e bashkëpunimit të mirë që kemi. Ministri Berisha nënvizoi faktin se FSK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besuar i sigurisë në vend, kjo besueshmëri tashmë ka trend pozitiv edhe te qytetarët serb të veriut. FSK-ja ka prezantuar rezultatin dhe suksesin e saj në integrimin e komuniteteve pakicë, në veçanti të komunitetit serb nga veriu i Kosovës.

Po ashtu, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral major Timothy Orr, priti në takim edhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, dhe se bashku biseduan për zhvillimet në FSK, përgatitjen e planeve për tranzicionin e saj dhe sfidat aktuale që po has ky proces.





Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Italisë



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha dhe ministrja e Mbrojtjes së Italisë, znj. Elisabetta Trena, në mjediset e Qeverisë të Republikës së Kosovës, sot nënshkruan Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtës të Republikës së Italisë. Në aktin solemn, të pranishëm ishin kryeministri i Republikës së Kosovës Ramush Haradinaj, ministri i MFSK-së Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rraham Rama, ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Italisë Elisabetta Trena dhe ambasadori i Italisë në Kosovë Piero Cristoforo Sardi.

Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Italisë parasheh bashkëpunimin e dyanshëm në fushën e trajnimeve, arsimimit dhe edukimit, shkëmbimin e përvojave në rrugën e integrimeve euroatlantike etj.

Ministri Berisha dhe ambasadori Ruairi O'Connell nënshkruan vazhdimin e marrëveshjes së bashkëpunimit

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha dhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut, z. Ruairi O'Connel nënshkruan në mjediset e MFSK-së amendamentin e Marrëveshjes bilaterale të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për FSK-në dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, të nënshkruar në vitin 2009.

Në takimin e përbashkët të ministrit Berisha dhe ambasadorit O'Connel u bisedua për marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet dy shteteve me theks të veçantë për marrëdhëniet e shkëlqyera në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe për gatishmërinë e të dyja palëve që këto marrëdhënie të ngritën në nivel më të lartë në të ardhmen.



Presidenti Hashim Thaçi dekoron gjenerallejtënant Rrahman Ramën me medaljen presidenciale

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar me Medaljen Presidenciale komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënantët Rrahman Ramën, me rastin e shënimit të 10- vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Dekorimi është bërë me motivacionin për kontributin e dhënë për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.

Medalja Presidenciale në 10-vjetorin e Pavarësisë u jepet personave që kanë dhënë kontribut për lirinë dhe pavarësinë e vendit.



Presidenti Hashim Thaçi dekoron zëvendësministrin Agim Çekun me medaljen presidenciale



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, më 22 shkurt ka dekoruar me Medaljen Presidenciale zëvendësministrin e MFSK-së, Agim Çekun, ish shef i Shtabit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me rastin e shënimit të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Dekorimi është bërë me motivacionin për kontributin e dhënë për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës. Medalja Presidenciale në 10-vjetorin e Pavarësisë u jepet personave që kanë dhënë kontribut për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Ministri dhe Komandanti pritën zëvendësshefin e Politikave dhe Planeve të ushtrisë së SHBA-ve për Evropë



Ministri i FSK-së Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama kanë pritur në MFSK zëvendësshefin e Politikave dhe Planeve të Komandës së Bashkuar për Evropë të ushtrisë së SHBA-ve gjeneral brigade Michael Turello, i cili shoqërohej nga një delegacion i gjerë ushtarakësh. Gjenerali Turello është ngarkuar të marrë pjesë në ushtrimin fushor "Shqiponja-6" nga Komandanti i Komandës së Bashkuar për Evropë të ushtrisë së SHBA-ve.

Takimet e ministri të FSK-së Rrustem Berisha në Konferencën e Halifaksit

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha takohet me Ministrin e Mbrojtjes të Kanadasë Harjit Sajjan



Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, gjatë pjesëmarrjes në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifax, është takuar me homologun e tij kanadez, Harjit Sajjan të cilin e ka njoftuar për procesin e tranzicionit të FSK-së, të arriturat dhe sfidat e kësaj force. Ministri Berisha e siguroi homologun e tij, se FSK-ja do të vazhdoj të mbetet forcë profesionale, multietnike, gjithëpërfshirëse, në shërbim të gjithë qytetarëve të saj dhe e përkushtuar për paqen dhe stabilitetin rajonal.

Takim i përbashkët i Ministrit dhe Komandantit të FKS-së me Zëvendës Sekretaren e Përgjithshme të NATO-së znj. Rose Gottemoeller.



Në Halifax, në margjina të Forumit Ndërkombëtar të Sigurisë, Ministri i FSK Rrustem Berisha dhe Komandanti Gjenerallejtënant Rrahman Rama, kanë zhvilluar një takim të përbashkët me Zëvendëssekretaren e Përgjithshme të NATO-së znj. Rose Gottemoeller. Ata e informuan gjerësisht, Zëvendëssekretaren për tranzicionin e FSK-së si dhe e siguruan atë se FSK-ja do të vazhdoj të mbetet forcë e përkushtuar, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, sipas standardeve të NATO-së. Ministri Berisha dhe Komandanti Rama e informuan numrin dy të NATO-së, për sfidat aktuale me të cilat po përballët Forca e Sigurisë, sidomos për qasjen destruktive të Serbisë, për të dekurajuar përmes shantazheve, pjesëtarët e kësaj force nga komuniteti serb.

Ministri Rrustem Berisha takon senatoren amerikane Jeanne Shaheen

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, në Halifaks ka zhvilluar një takim me senatoren amerikane, njëherësh anëtare e Komitetit të Senatit për Forcat e Armatosura, zonjën Jeanne Shaheen.Në takim.ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i kanë shprehur shqetësimin e tyre senatores Shaheen lidhur me fushatën kërcënuese që po u bëhet nga jashtë pjesëtarëve të komunitetit serb, të cilët po dekurajohen që të



shërbejnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralle-jtënant Rrahman Rama, qëndroi për vizitë në SHBA



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i shoqëruar edhe nga ambasadorja e Republikës së Kosovës Vlora Çitaku, atasheu i Mbrojtjes në SHBA kolonel Ilir Qeriqi, atasheu i Mbrojtjes së SHBA-ve në Prishtinë koloneli Jeffrey H. Fisher si dhe nga komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralmajor Timothy Orr, më 17 maj 2018 mori pjesë në ceremoninë e 25-vjetorit të Programit të Partneritetit Shtetëror (SPP) të Gardës Kombëtare të SHBA-ve, ku u prit nga gjeneral Joseph L. Lengyel, Komandant i Byrosë së Gardës Kombëtare në Kolegjin Kombëtar të Luftës, Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare Ft McNair, Washington DC.Gjeneral Rama e falënderoi Gjeneralin Lengyel për partneritetin e jashtëzakonshëm. Ai theksoi vizitën e fundit në Kosovë të mbi 100 qytetarëve të Ajovës nga sektorë të shumtë si: arsimi, bujqësia, biznesi i vogël, sporti, ushtria, siguria. Në veçanti i falënderoi për kontributin e zhvillimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 6".Në kuadër të kësaj vizite, gjeneral Rama u takua me zyrtarët të lartë të Departamenti të Shtetit, Mr. Matt Palmer dhe me ndihmës asistenten e Sekretarit të Mbrojtjes Ms. Laura Copper, me të cilët diskutoi mbi zhvillimet e fundit në FSK, sfidat e sigurisë në rajon dhe procesin e tranzicionit të FSK-së në FAK.

Komandanti i Operacioneve Speciale të NATO-s vizitoi Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së



Nënadmirali Colin J. Kilrain, komandanti Operacioneve Speciale të NATO-s, i shoqëruar nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, përcollën nga afër trajnimin „Niveli i parë për zhytje",të FSK-së në liqenin e Batllavës.Për delegacionin e lartë një material prezantues rreth trajnimit e paraqiti drejtori i Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së (QTKSH), z. John Doone si dhe shefi i QRTKSH, kapiten Besnik Hasani, të cilët folën për rëndësinë e këtij trajnimi, që është realizuar në tri lokacione, Pomozotin (pjesa teorike), Banjë të Malishevës dhe Batllavë (pjesa praktike e trajnimi).Shefi i instruktorëve, kapter Valdrin Kelmendi tregoi për ecurinë e trajnimit që realizohet me qëllim të ngritjes së numrit të zhytësve në kuadër të FSK-së.

Takimi i drejtorëve "Karta e Adriatikut –A5"



U zhvillua takimi i radhës i drejtorëve të Drejtorive të Politikave dhe Planeve të Ministrive të Mbrojtjes-Karta e Adriatikut A-5. Z. Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Planeve në Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës, mori pjesë në këtë takim. Takimi u zhvillua në Podgoricë nën organizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Malit të Zi. Takimi kishte në fokus stabilitetin rajonal, ndërkaq u zhvilluan diskutime lidhur me planin e veprimeve për këtë vit. Drejtori Faruk Geci, e vlerësoi si shumë të rëndësishme pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Drejtorisë së Politikave dhe Planeve të MFSK-së, veç tjerash edhe për faktin se u shpalos kërkesa e të gjitha shteteve pjesëmarrëse të Kartës së Adriatikut, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, për anëtarësimin e Kosovës në Kartën e Adriatikut A-5. Ai tha se është synimi ynë që gjatë kryesimit të Malit të Zi, të gjendet konsensusi i përbashkët për anëtarësimin e Kosovës në A-5. Në këtë takim u nënshkrua edhe Plani dypalësh i bashkëpunimit ndërmjet dy drejtorive, Drejtorisë së Politikave dhe Planeve të MFSK-së nga Faruk Geci dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Malit të Zi dhe Ivica Ivanoviç.

Ministri Rrustem Berisha mori pjesë në konferencën e ministrave të mbrojtjes SHBA-Karta e Adriatikut në Mal të Zi

Ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Malit të Zi, z. Predrag Boshkoviq, mori pjesë në punimet e Konferencës së ministrave të mbrojtjes „SHBA-Karta e Adriatikut" (A-5), që i zhvilloi punimet në qytetin e Budvës. Në Konferenë mori pjesë edhe, zv. ndihmës Sekretari i Mbrojtjes të SHBA-ve, Laura Kuper, ministri i FSK-së, z. Berisha, ministri i MBH-së, Marina Pendes, ministri i Kroacisë, Damir Krstiqeviq, i Maqedonisë, Radmilla Shekerinska, ministrja e Shqipërisë Olta Xhaçka, sekretari i Shtetit në MM të Sllovenisë, Millosh Bizjak, si dhe sekretari i Shtetit në MM të Serbisë, Aleksandar Zhivkoviq. Punimet i hapi kryetari i qeverisë



malazeze Dushko Markoviq, ndërsa, ministri i mbrojtjes, z. Boshkoviq, tha: „SHBA-Karta e Adriatikut" është një forum i rëndësishëm për promovimin e aspiratave euro-atlantike të vendeve të Evropës Juglindore, dhe instrument i fuqishëm për të forcuar bashkëpunimin rajonal në fushën e mbrojtjes. Zv. ndihmës Sekretari i Mbrojtjes të SHBA-ve, Laura Kuper, foli për rëndësinë dhe rolin e kartës së adriatikut në përforcimin e mirëkuptimit reciprok dhe besimit në vendet e rajonit. Pjesëmarrësit konfirmuan vendosmërinë që të kontribuojnë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore.

Ministri Rrustem Berisha merr pjesë në konferencën e ministrave të Mbrojtjes "SHBA-Karta e Adriatikut-A5" në Kroaci



Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Rrustem Berisha, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, z. Damir Krstiçeviq, po merr pjesë në punimet e konferencës speciale "SHBA-Karta e Adriatikut A-5", që po mbahet në Zagreb të Kroacisë. Në këtë konferencë po merr pjesë sekretari i Mbrojtjes i SHBA-ve, James Mattis, ministrat e Mbrojtjes të Kroacisë, Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Bosnjës e Hercegovinës.

Qëllimi i mbajtjes së konferencës „SHBA-Karta e Adriatikut A5" është integrimi rajonal, ballafaqimi me ndikimet e aktorëve të jashtëm dhe ndarja e përgjegjësive dhe barrës.Delegacioni i Kosovës, me këtë rast e ka njoftuar sekretarin e Mbrojtjes të SHBA-ve, James Mattis dhe të gjithë ministrat e Mbrojtjes të rajonit, për të arriturat e FSK-së, ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin në aspektin profesional.

Në MFSK u mbajt konferenca e tetë „FSK dhe Partnerët"



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, zhvilloi punimet konferenca dy ditore „FSK dhe Partnerët" me pjesëmarrje të ambasadorëve dhe atasheve ushtarakë të shteteve partnere. Kryeministri i Republikës së Kosovës Ramush Haradinaj shprehu falënderim për miqtë ndërkombëtarë: „ Ua kemi borxh të jemi partner me ju, sepse na keni ndihmuar në kohëra kritike që të jemi këtu ku jemi sot". Nga ana e tij, ministri i FSK-së Rrustem Berisha në fjalën e hapjes së punimeve të konferencës, fillimisht falënderoi të gjithë partnerët e FSK-së për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme drejt arritjes së synimeve të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha: „Pa mbështetjen tuaj, Forca e Sigurisë së Kosovë nuk do të ishte këtu ku është sot. Në organizatën tonë kultivojmë tri principe, atë të udhëheqjes, marrëdhënies dhe miqësisë". Gjatë sesionit të parë të konferencës, folën edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Cuoci, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Ralf Hoffmann, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, ambasadori i Gjermanisë, ambasadori i Turqisë dhe ambasadori i Kroacisë.

FSK-ja prezantoi të arriturat dhe sfidat në konferencën ,,Kosova e sigurt dhe e mbrojtur"

Në mjediset e Qeverisë së Kosovës, më 15 maj, nën organizimin e Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, u mbajt mbledhja prezantuese me temë: "Kosova e sigurt dhe e mbrojtur". "Kosova ka arritur nivelin e zhvillimit, i ka përmbushur argumentet e nevojshme që të ndodhë transformimi i FSK-së në ushtri të Kosovës, por duhet të vendosë për mënyrën e ecjes përpara", kështu ka deklaruar kryeministri Ramush Haradinaj, në takimin prezantues për arritjet dhe planet për sigurinë në përgjithësi, me theks të veçantë për FSK-në, me ambasadorët e akreditуar në Kosovë. Mbledhjen e udhëhoqi zv. ministri i FSK-së, Burim Ramadani, ndërsa, koloneli Jeton Dreshaj, këshilltar ushtarak i



Komandantit të FSK-së, shtjelloi të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Në emër të presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçit, foli Blerim Shala. Në mbledhje morën pjesë ambasadorët e akreditуar në Kosovë, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, drejtori i NALT-it, gjenerali Ralf Hoffmann dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve të sigurisë në vend.

Në Pentagon dhe Uashington D.C takohen Grupet Punuese për Politika të Sigurisë SHBA-Kosovë



Delegacioni i MFSK/FSK-së, gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, realizoi takime dypalëshe lidhur me avancimin e marrëdhënieve Kosovë-SHBA, në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Zv. ministri Burim Ramadani dhe zv. ndihmësja e Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes, znj. Laura Cooper, kanë bashkë-kryesuar mbledhjen e Grupit Punues për Politika të Sigurisë SHBA-Kosovë, të mbajtur në Pentagon. Në takim janë diskutuar dhe vendosur orientimet strategjike në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe SHBA-ve. Po ashtu, janë diskutuar çështjet e detajuara mbi angazhimet e përbashkëta në mbështetjen amerikane për Ministrinë e ardhshme të Mbrojtjes, me theks të veçantë për FSK-në në mandatin dhe detyrat e reja ushtarake dhe të mbrojtjes.

Delegacion i lartë i FSK-së vizitoi Qeverinë e Gjermanisë



Zëvendësministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe koloneli Jeton Dreshaj, që nga data 16.07.2018, po qëndrojnë për një vizitë zyrtare në Qeverinë Federale të Gjermanisë.Zëvendësministri Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama, gjatë kësaj vizite kanë realizuar takime të përbashkëta me zyrtarë të lartë të Qeverisë gjermane, ku kanë biseduar për zhvillimet dhe arritjet e përgjithshme të FSK-së, avancimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, si dhe për planet për avancim dhe bashkëpunim në të ardhmen. Zyrtarët gjerman kanë konfirmuar mbështetjen për FSK-në dhe Kosovën, duke përkrahur zhvillimin e kapaciteteve profesionale të institucioneve të Kosovës për siguri me qellim të thellimit të bashkëpunimit me Gjermaninë dhe NATO-n, në këtë aspekt.

Kosova dhe Italia thellojnë bashkëpunimin për siguri dhe mbrojtje



Zëvendësministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënantRrahman Rama kanë qëndruar për vizitë dyditore në Romë.

Delegacioni i MFSK-së është pritur nga niveli i lartë i Qeverisë italiane dhe Forcat e Armatosura të Italisë.

Në takimin e zëvendësministrit Ramadani dhe komandantit Rama me zëvendësministrin italian të Mbrojtjes, z. Raffaele Volpi, u diskutua për objektivat e Kosovës për anëtarësim në NATO, thellimin e bashkëpunimit dypalësh me Italinë, arritjet e FSK-së, planin gjithëpërfshirës për transformimin e FSK-së në ushtri, si dhe për vullnetin e Kosovës për t'i dërguar trupat e FSK-së në ndihmë të popujve në zona të ndryshme të krizave nëpër botë.

Zëvëndësministri Burim Ramadani dhe Komandanti i FSK-së Rrahman Rama vizitë në Republikën e Francës

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) z. Burim Ramadani, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe oficeri i lartë kolonel Jeton Dreshaj, po qëndrojnë për vizitë zyrtare në Republikën e Francës. Delegacioni i MFSK-së i shoqëruar edhe nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Paris z. Qëndrim Gashi u prit nga z. Thomas Bertin, drejtor për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtmetë Francës.



Në takimet që zhvilloi delegacioni i FSK-së në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Ministrinë e Mbrojtjes të Francës, janë diskutuar arritjet e FSK-së, bashkëpunimi dypalësh dhe avancimi i marrëdhënieve ndërmjet dy ministrive.

Sekretari i Përgjithshëm në ,,Konferencën vjetore të NATO-s ”

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Shkelzen Sylaj, mori pjesë në “Konferencën vjetore të NATO-s për Ngritje të Integritetit “ (NATO Anual Defence Confernce for Building Integrity), që u mbajt në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s (NATO Defence College) në Romë, Itali, me organizim të NATO - s dhe mbështetje të CIDS (Qendra Norvegjeze për Ndërtimin e Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes) nga Norvegjia. Fjalimin kryesor gjatë punimeve të kësaj konference e mbajti Sekretari i përgjithshëm i MFSK -së z. Shkelzen Sylaj, i cili i njoftoi të pranishmit me të arriturat e MFSK – së në ngritjen e integritetit. Ai po ashtu, ka ofruar kapacitetet



profesionale të Ministrisë së FSK-së në përkrahje të shteteve që janë në fazën e hartimit të planit të integritetit nëinstitucionet e tyre.

Sekretari i Përgjithshëm Shkëlzen Sylaj qëndroi për vizitë në Mbretërinë e Bashkuar



Një delegacion i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, në krye me sekretarin e përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj, me ftesë të ministrit të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, z. Mark Lancaster ka vizituar Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut. Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së z. Sylaj, së pari ka zhvilluar takim me ministrin e Forcave të Armatosura, z. Mark Lancaster, pastaj me shefen e Politikës së gjerë evropiane, zonjën Paula Hothersall si dhe me drejtorin e Sigurisë dhe Politikës Ndërkombëtare në Ministrinë e Mbrojtjes, z. Nick Gurr. Sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, e ka njoftuar ministrin Lancaster me zhvillimet në Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, në takim u shpreh gatishmëria e të dy palëve për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet MFSK -së dhe MM të Britanisë së Madhe.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama merr pjesë në Konferencën Vjetore të Ushtrisë Amerikane për Evropë



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, nga data 19-21.06.2018, po merr pjesë në Konferencën Vjetore të organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë, që po mbahet në Garmish të Gjermanisë. Qëllimi i mbajtjes së kësaj konference është thellimi i bashkëpunimit në Programin e Partneritetit Ndërshtetëror. Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës përkatësisht FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës (Iowa), është modeli më i mirë që tregon se si në një periudhë të shkurtër mund të arrihet progres në të gjitha nivelet e zhvillimit profesional të një force.

FSK-ja parakalon në 10 - vjetorin e shënimit të Pavarësisë së Kosovës



Në përvjetorin e dhjetë të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë, u mbajt manifestimi qendror, ku parakaluan edhe kuadratet e njësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës. Në tribunë ishin të pranishëm ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Timothy Orr dhe zyrtarë të lartë të ministrisë dhe oficerë madhorë të FSK-së. Manifestimi filloi me intonimin e Himnit shtetëror të Kosovës nga Orkestra frymore e FSK-së. Më pas, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrrahman Rama, raportoi para presidentit Thaçi, për gatishmërinë e Forcave të Sigurisë së Kosovës për parakalim.



Në kazermën e FSK-së ,,Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt ceremonia e 20-të vjetorit të "Epopesë së UÇK-së"



Në kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinajt, u mbajt manifestimi qendror për shënimin e 20-të vjetorit të Epopesë së UÇK-së, në nderim të Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit të rënë për liri. Pas revistës së kuadrateve të FSK-së, nga presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama,manifestimi filloi me intonimin e himnit shtetëror dhe atë kombëtar. Pastaj, presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramarush Haradinaj, ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, vendosen kurora lulesh pranë Obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit. Në përfundim të manifestimit Trupa muzikore e FSK-së, ekzekutoi disa pika muzikore me motive nga tradita, rezistenca dhe kultura e vendit tonë.



Në nderim të "Epopesë së UÇK-së" ministri dhe komandanti i FSK-së bënë homazhe te varri i Komandantit Legjendar Adem Jashari



Me rastin e manifestimit jubilar të 20-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së", rezistencës heroike të Familjes Jasharaj, të luftëtarëve tjerë, si dhe rënies së Komandantit Legjendar Adeam Jashari, pjesëtarëve të familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve për liri, ministri i FSK-së Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, të shoqëruar nga gjeneralë, oficerë madhorë të FSK-së, zyrtarë të lartë të ministrisë, bënë homazhe te varri i Komandantit Legjendar Adem Jashari në Kompleksin Memorial në Prekaz. Pas homazheve delegacioni i lartë i MFSK-së dhe FSK-së bënë vizitë në familjen Jashari, ku u pritën nga kryefamiljari i kësaj familje, z. Rifat Jashari.

Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti Rrahman Rama morën pjesë në manifestimin "Ditët e Shqipes"

Manifestimi "Ditët e shqipes" u organizua nën patronatin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Në këtë manifestim morën pjesë mijëra qytetarë nga të gjitha trojet shqiptare, kryetari i Kosovës Hashim Thaçi dhe kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Në fillim, ministri Berisha dhe gjenerallejtënant Rrahman Rama bënë homazhe në Varrezat e Dëshmorëve te Kompleksit Memorial në Koshare, si dhe takuan familjarët e dëshmorëve, të cilëve iu shprehën mirënjohje për veprën sublime të më të dashurve të tyre të rënë në altarin e lirisë.



Zhvillohet ceremonia e ndërrimit të komandës së Forcave Tokësore



Në kazermën „Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandës së Forcave Tokësore të FSK-së. Ceremonia filloi me parakalimin e flamurtarëve dhe intonimin e himnit shtetëror të Republikës së Kosovës. Pas leximit të dekretligjit të presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për emërimin e gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandant i Komandës së Forcave Tokësore dhe zëvendëskomandant i Forcës së Sigurisë të Kosovës, filloi ceremonia e ndërrimit të komandës së Forcave Tokësore nga gjeneral majori Gëzim Hazrolli tek gjeneral brigade Enver Cikaqi. Në fund u bë dorëzim-pranimi i detyrës së komandantit të KFT-së, nga gjeneral majori Gëzim Hazrolli tek gjeneral brigade Enver Cikaqi.

FSK-ja mbajti ceremoninë e ndërrimit të komandës në KDS



Në kazermën „Skënderbeu" të FSK-së në Ferizaj, u zhvillua ceremonia e ndërrimit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS). Komandanti i deritanishëm, gjeneral brigade Enver Cikaqi ia dorëzoi detyrën komandantit të sapoemëruar gjeneral brigade Irfete Spahiut. Gjeneral brigade Irfete Spahiu është oficerja e parë grua, e graduar në këtë rang, nga radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe oficerja e parë në detyrën e Komandantit të Brigadës.

Para të pranishmëve, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe gjeneral brigade Irfete Spahiu bënë dorëzim-pranimin e Komandës.

FSK-ja përfundoi me sukses ushtrimin fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6"

Udhëheqës shtetërorë dhe ushtarakë të Kosovës dhe të shteteve partnere më 11.05.2018, vizituan operacionet përfundimtare të ushtrimit fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6", në Kastriot, Batllavë dhe Koliq. Në fillim, në mjediset e ministrisë, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama priti gjeneralët dhe oficerët e shteteve partnere dhe drejtuesit e agjencive të Kosovës, të cilët i falënderoi për bashkëpunimin, koordinimin dhe ndërveprueshmërinë gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 6", ushtrim ky, i pari i këtij lloji, i planifikuar dhe ekzekutuar nga FSK-ja në bashkëpunim me agjencitë vendore dhe ushtritë partnere nga shtete të ndryshme. Drejtori i ushtrimit fushor "Shqiponja 6", gjeneral brigade Naim Haziri, për udhëheqësit shtetërorë dhe ushtarakë shpjegoi konceptin, objektivat, skenarin e ushtrimit më të madh vjetor të FSK-së, urdhrin operacional, javën akademike, pritjen dhe atashimin e kontingjenteve të shteteve mike në njësitë e FSK-së, dislokimin e njësive, ngritjen e kampit, funksionalizimin e komandës së përparme, atë të planifikimit si dhe me aktivitetet të tjera të ushtrimit ndërkombëtar "Shqiponja 6".

Në fund, pjesëmarrësit e rreshtuar në ushtrim, i falënderuan komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majori Timothy Orr. Në ushtrimin fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6", me njësi ushtarake morën pjesë: Garda Kombëtare e Ajovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kontingjente nga Kroacia, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Maqedonia dhe Republika e Shqipërisë, të cilat u atashuan në njësitë e FSK-së, pastaj Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Kryqi i Kuq i Kosovës. Në ushtrimin fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6" gjatë dy javëve sa zgjati ushtrimi morën pjesë gjithsej 1167 ushtarakë me mbi 147 automjete.





Ushtrimi i përbashkët "Shpata e Argjendtë 18"



Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), KFOR-i, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Policia e Kosovës, pas demonstrimit të aktiviteteve përfundimtare, realizuan me sukses ushtrimin fushor "Shpata e Argjendtë 18", në kazermën e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të Brigadës për Mbështetje Operacionale (BMO) të FSK-së "Evropianët e Rinj" në Pomozotin. Në këtë ushtrim, nëditën e vizitorëve, ishin të pranishëm: Ministri i FSK-sëRrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it gjeneral major Salvatore Cuoci, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, drejtori i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, përfaqësuestëAgjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, EULEX-it dhe Policisë së Kosovës. Të gjithë të pranishmit patën mundësinë të përcjellin nga afër operacionet e ekzekutuara me sukses nga institucionet dhe agjencitë e sigurisë dhe emergjencave në Kosovë.

Ushtrimi i përbashkët fushor "Shpata e Argjendtë 2018, është një ushtrim i bazuar në Planin e Reagimit Kombëtar me anë tëtëcilit testohen kapacitetet intervenuese të reaguesve të parë, dytë dhe të tretë. Ushtrimi "Shpata e Argjendtë 2018", është tregues i mirë i bashkëpunimit të FSK-së me institucionet dhe agjencitë e Kosovës.

FSK-ja mban punëtorinë ,,Ngritja e Kapaciteteve për Forcimin e Transparencës, Përgjegjshmërisë dhe Integritetit në Sektorin e Sigurisë"

Nën udhëheqjen e ekspertëve të NATO-s, Ministrisë së Mbrojtjes të Norvegjisë dhe KFOR-it, në MFSK u mbajt punëtoria me temën: „Ngritja e Kapaciteteve për Forcimin e Transparencës, Përgjegjshmërisë dhe Integritetit në Sektorin e Sigurisë". Punëtoria u mbajt në kuadër të rritjes së bashkëpunimit NATO-Kosovë. Në sesionin e parë të punimeve morën pjesë: ministri Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, sekretari



i përgjithshëm Shkelzen Sylaj dhe drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për MFSK/FSK, gjenerali Ralf Hoffmann.

Pjesëtarët e FSK-së stërviten në Gjermani



Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Enver Cikaqi vizitoi nga afër operacionet e ushtrimit "Comabined Resolve X", ku po marrin pjesë edhe 15 pjesëtarë të FSK-së në Ditën e Vizitorëve të Shquar, krahas personaliteteve tjera ndërkombëtare, në Gjermani. Gjenerali Cikaqi, nga drejtuesit e ushtrimit mori komente dhe vlerësime shumë të larta për angazhimin, disiplinën dhe profesionalizmin që po tregojnë pjesëtarët e FSK-së, të cilët gjatë zhvillimit të këtij ushtrim kanë pasur mundësi të punojnë dhe operojnë krah për krah me kolegët e tyre nga ushtritë ndërkombëtare, duke përfituar nga shkëmbimi i përvojave se si duhet punuar dhe vepruar në një mjedis shumëkombësh. FSK në këtë ushtrim mori pjesë me një kontingjent prej 15 pjesëtarësh. Fokusi dhe objektivi i këtij ushtrimi është ndërveprimi operacional i të gjithë pjesëmarrësve nga ushtria e NATO-s dhe aleatëve tw tjerë, për të kuptuar dhe krijuar procedura operuese të përbashkëta. Ky është ushtrim shumëkombësh i operacioneve të unifikuara tokësore (Multi Unifeied Land Operation), i drejtuar nga Shtabi i Departamentit të Ushtrisë së SHBA-ve, për të stërvitur forcën e caktuar rajonale të SHBA-ve, të nivelit të brigadës, në mbështetje të objektivave të Komandës Evropiane të SHBA-vë (EUCOM), për bashkëpunim dhe siguri, ndërtimin e gatishmërisë me aleatët dhe partnerët e NATO-së.

Policia e FSK-së zuri vendin e tretë në garën për forcimin e ligjit



Në kampin e KFOR-it amerikan në Bondsteel (Ferizaj), më 20.06.2018 u mbajt gara testuese e ekipeve të njësive të forcimit të ligjit në Kosovë dhe të vendeve partnere, për përgatitjen e tyre fizike dhe psikike si dhe detyra tjera policore. Të gjitha ekipet pjesëmarrëse gjatë testimit/garës kanë kaluar nëpër këto disiplina: gjuajtje aktive, fitnes fizik, shkathtësi të ngasjes emergjente, gjuajtje nën presion me pistoletë 9mm, ndalesë të trafikut me rrezikshmëri të lartë, shkathtësi të angazhimit në vend-incident dhe neutralizimin e një personi. Në këtë garë morën pjesë gjashtë ekipe të forcimit të ligjit: Policia e Forcës së Sigurisë të Kosovës, Policia Ushtarake Ndërkombëtare e KFOR-it, Policia e Kosovës, Policia Kufitare e Kosovës, Policia Ushtarake Gjermane dhe Policia Ushtarake Amerikane. Ekipi i Policisë i Forcës së Sigurisë të Kosovës zuri vendin e tretë, duke u radhitur pas Ekipit të Policisë Ushtarake Amerikane (vend i parë) dhe Policisë Ushtarake Ndërkombëtare nga KFOR-i (vend i dytë). Komandanti i Kampit Bondsteel, koloneli Nick Ducic, në fund, ekipeve fituese u dhuroi mirënjohje dhe medalje për suksesin e treguar gjatë kësaj gare.

Diplomoi gjenerata 2018 e kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj, më 25 qershor, u zhvillua ceremonia e diplomimit të kadetëve „Gjenerata 2018" të QSU-së. Me gradën nëntoger u graduan gjithsej11 oficerë të rinj, të cilët me sukses mbaruan shkollimin katërvjeçar për udhëheqje në Qendrën për Studime Universitare dhe në Universitetin Amerikan në Prishtinë. Me këtë rast, ministri Berisha, tha: „sot është një ditë e veçantë për FSK-në, sepse në këtë ceremoni, po diplomojnë dhe po gradohen 11 kadetë të FSK-së, „Gjenerata 2018. Gjatë kësaj periudhe katërvjeçare, ju keni kaluar nëpër sfida të shumta të cilat falë punës, angazhimit dhe vendosmërisë i keni përfunduar me sukses, andaj që nga sot, po gradoheni me gradën e nëntogerit. Gradimi juaj në oficerë të FSK-së, po bëhet në një fazë shumë të rëndësishme të zhvillimit të FSK-së, kur edhe pritet që kjo Forcë t'i avancojë kapacitetet operacionale dhe ta ndryshoj misionin e saj. Ky standard i arritur është një shembull i qartë i zhvillimit dhe progresit që po e bën FSK-ja me profesionalizëm dhe me standarde të larta ushtarake të NATO-s."

Në Akademinë e Mbrojtjes në Shkup diplomoi oficer i FSK-së nga radhët e komuniteteve

Në Akademinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, më 19 tetor ka diplomuar një oficerdhe ka filluar studimet për katër vitet e ardhshme një kadet i ri i FSK-së. Një ceremoni solemne, gjithashtu u zhvillua edhe në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup, ku të dy pjesëtarët e FSK-së, dhanë betimin për shërbim në Forcën e Sigurisë të Kosovës, krahas oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së. Në ceremoni ishte i pranishëm edhe një delegacion i FSK-së, në krye me gjeneralin Nazmi Brahimaj, drejtor i Departamentit për Operacione dhe Trajnime në MFSK.



Diplomojnë rekrutët e rinj të FSK-së nga radhët e komuniteteve joshumicë



Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, më 16 mars u mbajt ceremonia e diplomimit të rekrutëve të rinj të FSK-së nga radhët e komuniteteve joshumicë, gjenerata e parë për vitin 2018. Me këtë rast, kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj uroi rekrutët e rinj të FSK-së, nga radhët e komunitetit joshumicë për përfundimin me sukses të trajnimit bazik duke ju dëshiruar fillim të mbarë, shërbim dhe karrierë të suksesshme në FSK. Ndërsa, ministri Berisha, tha se: „Ceremonia e sotme na gëzon shumë, sepse dëshmon se FSK-ja është bërë forcë e besueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, forcë shumetnike, e hapur për të gjithë dhe në shërbim të të gjithëve. Njëri nga prioritetet tona është edhe integrimi i komuniteteve joshumicë në strukturën e FSK-së. Bazuar në Strategjinë për integrim të komuniteteve dhe në këtë angazhim, aktualisht FSK-ja e ka tejkaluar kuotën prej 10% të përfshirjes së komunitetit joshumicë. FSK-ja për disa vite me radhë është vlerësuar nga qytetarët si institucioni më i besueshëm i vendit, prandaj është detyrë e juaja dhe e jona për ta bërë FSK-në, edhe në të ardhmen, forcë kompakte, shumetnike dhe të besueshme". Kurse e ngarkuara me punë në Ambasadën e SHBA-ve, Colleen Hylland uroi rekrutët e rinj për përfundimin me sukses të trajnimit bazik.

Ekipi i FSK-së fitoi medaljen e bronztë në garën e patrullimit "Cambrian Patrol"



Ekipi i përzgjedhur i FSK-së, i udhëhequr nga togeri Behar Fazliu, oficer në Batalionin e Dytë të Reagimit të Shpejtë, arriti të fitojë ,Medaljen e bronztë, në garën ndërkombëtare të patrullimit në Uells, garë kjo, me një konkurrencë të fortë, ku prej 137 ekipeve; 37 prej tyre ishin ekipe të ushtrive ndërkombëtare. Të gjitha ekipet pjesëmarrëse në garë në realizimin e skenarit të stërvitjesu përballënme vështirësitë e mëdha të motit që shkaktoi stuhia „Cullum". Në këtë garë, ekipi i FSK-së përshkoi një sfidë lundrimi me gjatësi prej 80 kilometrash, përmes një sërë skenarësh të dizajnuar për të testuar udhëheqjen, punën ekipore dhe durimin fizik dhe mendor të ekipit. Përveç Republikës së Kosovës, në garën ndërkombëtare patrulluese në Mbretërinë e Bashkuar morën pjesë edhe ekipet e Forcave të Armatosura të vendeve të rajonit, si nga Shqipëria, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.

Shpallet "Ushtari i vitit 2018" i garës së FSK-së dhe garës ndërkombëtare



Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, më 27 prill, solemnisht u shpallën rezultatet e garës ndërkombëtare dhe të garës së FSK-së "Ushtari më i mirë i vitit 2018". Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se kjo garë tashmë është bërë internacionale dhe qëllimi i saj është që të promovojë shpirtin garues të ushtarëve dhe të rrisë motivimin e tyre, si dhe shprehu admirimin që në këtë garë kanë marrë pjesë ushtarakë nga tetë shtete partnere me gjithsejtë 17 garues. "Unë i falënderoj shtetet partnere, të cilat i janë përgjigjur pozitivisht ftesës për të marrë pjesë në këtë garë. Ju tashmë keni krijuar ura të bashkëpunimit, dhe njëkohësisht keni krijuar lidhje shoqërore, e që është njëra ndër qëllimet kryesore të kësaj gare". Ndërsa, rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj theksoi se gara "Ushtari më i mirë për vitin 2018", si në nivel të FSK-së ashtu edhe atë ndërkombëtar është planifikuar, organizuar dhe ekzekutuar nga nënoficerët e FSK-së, dhe zbatimi i suksesshëm, i një aktiviteti të tillë, është treguesi më i mirë se kemi krijuar një trupë profesionale të nënoficerëve. Në fund u shpallën rezultatet e të dyja garave. Titullin "Ushtari më i mirë i vitit 2018", në nivel të FSK-së e fitoi tetari Lorik Ramaj (BRSH), vendin e dytë tetari Berat Babaj, (BRSH) dhe vendin e tretë ushtari Egzon Jashari (BMO). Ndërsa fituesit e garës ndërkombëtare ishin: Vladimir Haxhijaj, ushtaraku nga Shqipëria, tetari Joery Hinssen dhe ushtari Aaron Braun nga Forcat e Armatosura të Kanadasë. Në këtë garë morën pjesë 22 garues nga FSK-ja dhe 17 garues ndërkombëtar, si nga Shqipëria, Belgjika, Kanadaja, Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Kadetët e FSK-së në ushtrimin fushor ,,Kampi veror 2018" në Krivollak



Në poligonin ushtarak në Krivollak të Republikës së Maqedonisë, më 6 korrik, kadetët e shteteve pjesëmarrëse me sukses përfunduan operacionet përfundimtare në kuadër të ushtrimit 12-ditor ,,Kampi veror 2018". Në këtë ushtrim, krahas kadetëve të SHBA-ve, Gjermanisë, Shqipërisë, Maqedonisë, Austrisë, Bosnje Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Norvegjisë, morën pjesë edhe kadetët e FSK-së, të cilët demonstruan me sukses aftësitë e tyre profesionale dhe nivelin e gatishmërisë. Ushtrimin fushor të kadetëve e përcolli nga afër edhe gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, shef i Departamentit për Operacione në MFSK, i cili në emër të komandantit të FSK-së, ka përgëzuar të gjithë kadetët e FSK-së, për motivimin, disiplinën, profesionalizmin dhe ndërveprimin me kadetët në ambient ndërkombëtar. Në ditën e fundit të ushtrimit fushor, kadetët pjesëmarrëse, gjatë demonstrimit, përbënin një batalion shumëkombësh që ishin të ngarkuar me detyra të operimit dhe realizimit të tyre në terren.

Gjenerata e re e kadetëve të FSK-së solemnisht dhanë betimin



Në kazermën ,,Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, në Prishtinë, më 28 shtator, kadetët e rinj të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, dhanë betimin e kadetit. Pas rreshtimit dhe intonimit të himnit shtetëror, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, pranoi raportin nga komandanti i Qendrës për Studime Universitare, majori Vegim Kelani. Në fjalën e tij, ministri Berisha i përgëzoi kadetë e rinj për fillimin e vitit akademik dhe i uroi për betimin e kadetit. Ministri vlerësoi lart përzgjedhjen e tyre për t'i shërbyer vendit, duke ju thënë se ju do të kultivoni dhe do të ngrini edhe më lart vlerat e lirisë së vendit tonë. Nga ana e tij, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, foli për sistemin e shkollimit dhe përgatitjen e oficerëve të FSK-së, të cilët po shkollohen në QSU-së, si dhe për kualitetet që ata po bartin në detyrë gjatë shërbimit. Gjithashtu, ai vlerësoi lart edhe përgatitjen akademike të kadetëve në Universitetin Amerikan në Kosovë.

Oficerët e FSK-së më të mirët në Mbretërinë e Bashkuar



Tre oficer tëFSK-së, nëntoger Besfort Kurteshi, nëntoger Eugen Thaçi dhe toger Ismail Hoxha, më 10 janar 2018 udhëtuan përnë Mbretërinë e Bashkuar, për një trajnim profesional. Kjo periudhë shënoi fillimin e një viti të suksesshëm të marrëdhënievendërmjet Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe FSK-së. Nëntogeri Besfort Kurteshi ishte pjesë e Akademisë Ushtarake Mbretërore ,,Sandhurst,,. Ky është kandidati i 18-të i FSK-së, që shkollohet në këtë akademi ushtarake. Ndërsa, nëntogeri Eugen Thaçi qëndroi në Edinburg të Skocisë, për para-trajnim që drejtohet nga Shkolla e Trajnimit të Këmbësorisë. Nëntogeri Thaçi studioi taktikat e Ushtrisë Britanike dhe mësoi përdorimin e pajisjeve britanike në kushtet e dimrit skocez. Pas këtij trajnimi sfidues, Thaçi ishte edhe në Uells, ku kreu Kursin Luftarak për komandant të togës. Kurse togeri Ismail Hoxha, pas sukseseve në Akademinë Ushtarake ,,Sandhurst,,ku fitoi ,,Shpatën" si studenti më i mirë ndërkombëtar, dëshmoi aftësi profesionale edhe në garën me prestigjioze ,,Cambrian Patrol" ku zuri vendin e parë me njësitin e tij. Togeri Hoxha kësaj radhe ishte në cilësinë e instruktorit të FSK-së në Britani të Madhe dhe në Skoci, kreu edhe detyrën e instruktorit për kadetët britanikë, kurse në Uells ishte instruktor në Kursin Luftarak për Komandant të Togut. Shumë rrallë ndodh të zgjidhën instruktorë nga personeli ndërkombëtar për të trajnuar oficerët britanikë. Kjo është një arritur e madhe për togerin Ismajl Hoxha dhe FSK-në.

Pjesëtarët e FSK-së më të mirët në garën ndërkombëtare të mjekësisë

Në Grafenworth të Gjermanisë u mbajte gara ndërkombëtare "Ekspert i Mjekësisë Fushore", në të cilën morën pjesë mbi 200 pjesëtarë nga shumë vende të botës, si nga: SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Danimarka, Norvegjia, Kosova etj. Pjesë e kësaj gare ishin edhe tre pjesëtarë të Qendrës Trajnuese të Kërkim-Shpëtimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së. Gara kishte për qëllim koordinimin dhe aftësimin e pjesëmarrësve në përdorimin e teknikave të reja mjekësore, si dhe ngritjen e nivelit reagues gjatë fushëbetejave reale dhe fitimin e begjit. Begjin si ekspertë të mjekësisë fushore e kanë fituar 23 pjesëmarrës. Në mesin e fituesve; Besart Ejupi dhe Kushtrim Hyseni janë shpallur ndër më të mirët edhe në nivel Evrope.



Toger Albert Asllani oficeri më i mirë ndërkombëtar në kursin "Kapiten i karrierës" në SHBA



Oficeri i FSK-së, togeri Albert Asllani, pas një trajnimi gjashtëmujor në shkollën ushtarake ,,United States Army Cyber Center of Excellence" në Fort Gordon të SHBA-ve, u nderua me çmimin "Colonel Alan C. Dexter, OBE, Award". Këtë çmim e marrin studentët e dalluar të cilët tregojnë arritje të larta akademike si dhe profesionalizëm dhe lidership gjatë studimeve. Çmimi "Colonel Alan C. Dexter, OBE, Award" për Toger Asllanin është edhe një dëshmi se FSK-ja është në rrugë të duhur sa i përket ngritjes profesionale të pjesëtarëve të saj, dhe se ky kualitet profesional është duke u dëshmuar edhe jashtë vendit si në: shkollime, trajnime, operacione, përfshirë këto edhe në akademitë më prestigjioze në botë. Në këtë trajnim kanë marr pjesë oficerë nga shumë vende të botës.

FSK-ja pajiset me automjete taktike amerikane ,,Hamvi"

Në Ministrinë për FSK-në, më 17 qershor, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe ambasadori i SHBA-ve, Greg Delavie nënshkruan aktin final të kontratës për furnizim me automjete shumë funksionale ushtarake me lëvizshmëri të lartë nga Qeveria e Kosovës me kompaninë amerikane ,,AM General" për furnizim të FSK-së. Kryeministri Haradinaj, tha se:,,Forca jonë e sigurisë po modernizohet me teknikë ushtarake shumë funksionale "Hamvi". Ndërsa, ministri Rrustem Berisha tha: ,, Mjetet taktike ,,Hamvi" do të jenë në shërbim të FSK-së, dhe ky akt i nënshkrimit është i një rëndësie të veçantë që i kontribuon thellimit të bashkëpunimit me SHBA-të, avancimit të FSK-së, si dhe rrit shkallën e ndërveprueshmërisë me shtetet e NATO-s". Ministri Berisha falënderoi SHBA-të



për mbështetjen e pakursyer në vazhdimësi e sidomos në kuadër të trajnimeve, edukimit apo edhe pajisjeve përmes Zyrës për Bashkëpunim Ushtarak (ODC) dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Nga ana e tij, ambasadori Delavie tha: ,,Sot po kremtojmë nënshkrimin e kontratës për furnizim ndërmjet FSK-së dhe kompanisë ,,AM General'' dhe se më vjen mirë që FSK-ja e ka përzgjedhur Hamv-në si automjetin e ardhshëm të saj.

Gjermania i dhuroi FSK-së 44 automjete taktike dhe pajisje të tjera përcjellëse



Komandanti i Forcë së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shefi i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe Forcën (NALT), gjeneral brigade Uwe Becker, solemnisht bënë dorëzim-pranimin e donacionit prej 44 automjeteve taktike dhe 77 kompleteve me pajisje speciale, që Forcat e Armatosura të Gjermanisë i kanë dhuruar FSK-së. Nënshkrimit të dy gjeneralëve i ka paraprirë nënshkrimi i aktit zyrtar të pranim-dorëzimit të donacionit, të cilin në emër të Ministrisë për FSK-në e nënshkroi sekretari i përgjithshëm dr. Shkelzen Sylaj dhe në emër të Kontingjentit gjerman të KFOR-it nënkoloneli dr. Eric Offermann. Me këtë rast, ministri i FSK-së Rrustem Berisha falënderoi Qeverinë e Gjermanisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe popullin gjerman, për mbështetjen e vazhdueshme që po afron për Kosovën dhe Forcën e saj, sidomos në zhvillimin e saj me trajnime, stërvitjet dhe donacione. Shteti gjerman në vazhdimësi e ka mbështetur FSK-në dhe Republikën e Kosovës në aspektin politik, ekonomik dhe atë të sigurisë. Ndërsa, Komandanti i FSK-së, pasi falënderoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe popullin gjerman për këtë donacion, tha: „Ishte Gjermania ajo, që në fillimin të ngritjes së FSK-së në vitin 2009 e ndihmoi FSK-në me 204 automjete taktike, pajisje mjekësore, pjesë rezervë etj., Falë kësaj mbështetjeje FSK-ja arriti atë vit kapacitetet e para operacionale. Tani, po nga Gjermania vjen edhe një donacion tjetër, 44 automjete taktike dhe pajisje përcjellëse. Ky donacion është tejet i rëndësishëm për të vazhduar rrugëtimin tonë drejt zgjerimit të aftësive dhe vazhdimin e punëve të mira në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe popullit të Kosovës“. Ambasadori i Gjermanisë, Christian Heldt, vuri theksin tek marrëdhëniet e mira ndërmjet Ushtrisë së Gjermanisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kurse shefi i NALT-it, gjenerali Uwe Becker tha se, ndihet i privilegjuar që në emër të Ministrisë së Mbrojtjes po ia dhuron këto automjete FSK-së. ,,Këto automjete do t'u takojnë juve si mbrojtës të popullit të Kosovës. Siguria në Kosovë po bartet çdo ditë e më shumë tek autoritetet kosovare që do të jenë të vetmit dhe kryesorët për sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë, jo vetëm në letër por edhe në praktikë“.

Performojnë së bashku Bendi i Forcave Ajrore Amerikane dhe ai i FSK-së

Në hollin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me rastin e 10- vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, më 14 shkurt, Bendi muzikor i Forcave Ajrore të Ushtrisë Amerikane për Evropë së bashku me Orkestrën frymore të FSK-së, ekzekutuan muzikë të larmishme për pjesëtarët e FSK-së.



Përurohet ura mobile e ndërtuar nga FSK-ja në Shqipëri



Me 15 shkurt, me një ceremoni solemne, u bë përurimi i urës mobile në fshatin Zëmblak të prefekturës së Korçës, ndërtuar nga xhenierët e FSK-së. Zv. ministri Burim Ramadani përgëzoi xhenierët e FSK-së dhe të Shqipërisë, për punën e shkëlqyeshme që kanë bërë në ngritjen e urës në fshatin Zëmblak të Korçës. Ai, veç tjerash tha se ,,jemi këtu për të dëshmuar gatishmërinë e Kosovës, institucioneve dhe FSK-së, që të ofrojmë ndihmë edhe për të tjerët, për Shqipërinë, për rajonin, si edhe më gjerë. Rruga e vetme që sjellë sukses dhe qëndrueshmëri për të gjithë ne, në rajon, është rruga e bashkëpunimit të plotë ndërshtetëror, rruga e mbështetjes së njeri-tjetrit, rruga e integrimit euroatlantik". Ndërsa, ministrja e Mbrojtjes, znj. Xhaçka, ka falënderuar Qeverinë e Kosovës dhe FSK-në, për ndihmën në sanimin e shpejtë të gjendjes pas vërshimeve në Shqipëri.

FSK-ja dhuroi qindra doza gjak për qytetarët e Kosovës



Bazuar në planin e veprimit për vitin 2018 të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Departamentit të Mjekësisë në MFSK, në koordinim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës, në MFSK dhe FSK, u zhvillua aksioni humanitar për dhurimin e gjakut, në dy faza. Këtij aksioni iu përgjigjen një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së dhe stafit civil të MFSK-së. FSK-ja tashmë ka një traditë të organizimit të aksioneve humanitare për dhurimin vullnetar të gjakut, me moton ,,një pikë gjak për shpëtimin e një jete". Zv. ministri Burim Ramadani tha: ,,FSK-ja gjithmonë i përgjigjet jo vetëm aksioneve të organizuara për dhurimin e gjakut, por edhe sa herë paraqitet nevoja dhe bëhen thirrje individuale për ndihmë përfshirë edhe dhurimin e gjakut". Ndërsa, dr. Bukurije Zhupi, nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës, shtoi: ,,Pjesëtarët e FSK-së janë bërë një shembull i mirë për të ndihmuar qytetarët e Kosovës dhe për ngritjen e vetëdijes te qytetarët, që t'i përgjigjen aksionit humanitar për dhurimin e gjakut dhe aksioneve të ngjashme humanitare". FSK-ja çdo viti dhuron qindra doza gjak për QKTGJK-së.

Komandanti i FSK-së merr pjesë në diplomimin e dy kadetëve në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sundhurst"




Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të dy kadetëve të FSK-së, nëntogerëve Kemajl Haliti dhe Çlirim Morina. Të dy kadetët e FSK-së, përfunduan me sukses trajnimin 12 mujor, i cili ka qenë i bazuar në një program mjaft intensiv, më qellim që të përgatisë oficerët e rinj; që të jenë udhëheqës kompetent, të aftë të marrin gjykime të drejta, dhe të kryejnë detyrat në mënyrë profesionale. Nëntogeri Kemajl Haliti, është oficer i ri i FSK-së nga radhët e komunitetit ashkali, që paraprakisht ka mbaruar shkollimin në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, dhe ishte përzgjedhur për studime në Akademinë Ushtarake Mbretërore ,,Sundhurrst", mundësi kjo, që aplikohet në barabarësi për të gjithë pjesëtarët e FSK-së. Pas kthimit nga Mbretëria e Bashkuar, nëntogerët Haliti dhe Morina do të shërbejnë në FSK, me detyrën komandant togu, në Batalionin e Parë të Reagimit të Shpejtë në Gjilan, respektivisht në Batalionin e Dytë të Reagimit të Shpejtë në Istog.

Komandanti i FSK-së, dekoroi me medaljen ,,Shërbim vetëmohues" pjesëtarët e Kërkim-Shpëtimit



Në një ceremoni të organizuar në Regjimentin e Mbrojtjes Civile, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka dekoruar me medaljen ,,Shërbim Vetëmohues" pjesëtarët e Task Forcës të Kërkim-Shpëtimit. Gjenerali Rrahman Rama, me këtë rast, tha: „Unë ju përgëzoj për punën dhe angazhimin. E di dhe e kuptoj se në çfarë kushtesh ju veproni dhe çfarë rrezikshmërie keni në punën tuaj. Kam qenë vet prezent në kërkimin e dy policëve të aksidentuar. Po ashtu kërkimi dhe gjetja e viktimës vikendin e kaluar tregon për punën dhe angazhimin serioz që ju jeni duke bërë. Shpresoj që kurrë mos të kemi thirrje për angazhimin tuaj, se e di sa e vështirë është të gjesh dhe të tërheqësh një viktimë, por ju e keni treguar me punën tuaj, se jeni të gatshëm dhe të përgatitur për çdo situatë". Në fund, gjeneral Rama, pjesëtarëvetë Task ForcëssëKërkime –Shpëtimit iu ndau medalje për ,,Shërbim Vetëmohues". Vlen të theksohet se pjesëtarët e Kërkim–Shpëtimit të FSK-së në vazhdimësi janëtë angazhuar në operacione dhe se të gjitha operacionet i kanë përfunduar me sukses.

FSK-ja më e besueshmja për qytetarët e Kosovës



Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) bëri publikimin e edicionit të shtatë të Barometrit Kosovar të Sigurisë dhe sipas rezultateve doli që FSK-ja është institucioni më i besueshëm i sigurisë në vend. 78% e qytetarëve të vendit të anketuar e besojnë FSK-në. Besueshmëria nga viti i kaluar ka shënuar rritje në masën prej 11%. Kjo gjë ka ndikuar edhe në rritjen e besueshmërisë në veri të vendit tonë.

Zbulohet Pllaka përkujtimore në nderim të ushtarëve të NATO-s në Prishtinë



Nën patronatin e Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, më 12 qershor në Prishtinë, me një ceremoni shtetërore u bë zbulimi i Pllakës përkujtimore, në nderim të ushtarëve të NATO-s dhe KFOR-it, të rënë në Kosovë që nga 12 qershori 1999. Në Obelisk shkruan: „Në kujtim të burrave dhe grave që kanë shërbyer me partnerët e tyre në KFOR dhe kanë dhënë jetën si rezultat i shërbimit të tyre. Ne nderojmë dhe përkujtojmë sakrificën e tyre“.

FSK –ja mbështet qytetarët e Komunës së Suharekës pas vërshimeve



Më 17 gusht 2018, Njësia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza dhe Batalioni i Xhenios u dalin në ndihmë institucioneve dhe qytetarëve të Suharekës, në përballimin e situatës së shkaktuar pas vërshimeve të shiut, në mënyrë që banorët e kësaj ane t'i kthehen sa më shpejt jetës normale. Operacionet e FSK-së janë marrë me pastrimin e rrugëve, largimin e ujit me pompa nga objektet e banimit, largimin e shumë objekteve të forta nga rrugët dhe trotuaret, të cilat janë bartur nga shirat e shumta që kanë rënë në natën e 15 gushtit në këtë komunë. Në këtë operacion, FSK-ja ka angazhuar teknikën e saj, si: autocisterna për pastrimin e rrugëve dhe parandalimin e erozionit; kamionë Kiper, për ngarkimin dhe transportimin e dheut dhe zhavorrit si dhe ekskavatorë për kryerjen e punimeve në evitimin e dëmeve në fshatrat: Greiqec, Papaz dhe Leshan.

Policia e FSK-së realizon trajnim në Bondsteel



Në kuadër të bashkëpunimit tëFSK-së me KFOR-in, për dy javë rresht, në kampin Bondsteel, Policia e Forcës së Sigurisë të Kosovës ka realizuar trajnimin ,,Zbatimi i Ligjit në Policinë Ushtarake". Ky trajnim është realizuar nga instruktorë të Policisë Ushtarake Amerikane. Trajnimi ka filluar më 15 janar dhe ka përfunduar më 30 janar. Trajnimi është fokusuar në temat: Reagimi në aksident të trafikut dhe hetimi i aksidentit; Ndalesat në trafik; Ndalesat në trafik me rrezikshmëri të lartë etj. Ky trajnim si dhe trajnimet tjera që janë realizuar nga instruktorët e Ushtrisë Amerikanejanë rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes dy vendeve. Instruktorët amerikanë i priti gjenerali Gëzim Hazrolli, i cili i falënderoi për ndihmën e dhënë në ngritjen profesionale tëpjesëtarëvetë FSK-së.

Ushtari Alban Fazliu i dyti në Maratonën Kombëtare të Krosit në Shqipëri



Në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Sporteve Ushtarake, "CISM DAY-RUN FOR PEACE", në Maratonën e mbajtur në Tiranë më 12.02.2018 morën pjesë edhe 10 pjesëtarë të FSK-së. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë iu bashkuan ushtrive të 135 vendeve nga mbarë bota në Ditën Ndërkombëtare të Sporteve në Ushtri. Në maratonën e Tiranës morën pjesë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të të gjitha gradave dhe nga të gjitha komandat, njësitë dhe repartet e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

FSK-ja mori pjesë në aksionin për "Ditën e Tokës"



FSK-ja me personel dhe pajisje xheniere më 22-23 prill mori pjesë në shënimin e "Ditës së Tokës" dhe mbështeti aksionin vullnetar "Ta pastrojmë Kosovën", aksion ky i organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës. Për të përkrahur aksionin kishin marrë pjesë edhe gjeneralë, oficerë, ushtarë dhe zyrtarë të lartë tëMFSK/FSK-së, së bashku me zyrtarë të organizatave dhe shoqërisë civile, të Policisë së Kosovës, përfaqësues të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK, nxënës si dhe qytetarë, të cilët u angazhuan përgjatë gjithë ditës në pastrimin dhe mbjelljen e drurëve dekorativë dhe luleve nëpër komunat e Kosovës.

Përmbajtja

Viti i zhvillimeve pozitive për FSK-në dhe Kosovën....3
Viti i ndryshimit të madh për FSK-në....4
Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës votuan në lexim të parë tri projektligjet për MFSK/FSK-në....5
Projektligjet për transformimin e MFSK/FSK-së miratohen unanimisht në Qeverinë e Republikës së Kosovës....5
Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi ka graduar dhe emëruar gjeneralët e FSK-së....6
Ministri i FSK-së priti në vizitë ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi....6
Ministri Rrustem Berisha priti ministren e Mbrojtjes të Maqedonisë Radmilla Shekerinska....7
Ministri i FSK-së Rrustem Berisha priti në vizitë ministren e Mbrojtjes të Francës,
znj. Genevieve Darrieussecq....7
Ministri Rrustem Berisha viziton Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë....8
Ministri Rrustem Berisha u prit me nderime të larta ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes të Kroacisë....8
Ministri Berisha u prit nga presidenti Ilir Meta dhe ministrja Olta Xhaçka....9
Vizita e asistentit të Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve Robert Karem në MFSK....9
Komandanti i FSK-së priti në vizitë shefin e Mbrojtjes të Gjermanisë....10
Shefi i Ushtrisë së Italisë Gjenerallejtënant Salvatore Farina u prit në FSK....10
Ministri FSK-së priti zëvendës-asistentin e Sekretarit Gjeneral të
NATO-s për çështje operacionale,John Manza....11
Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, priti në vizitë ministrin e Mbrojtjes të Irlandës, z. Paul Kehoe....11
Ministri Rrustem Berisha u prit nga Sekretarja e Shtetit pranë 12
Ministrisë së Armatave të Francës znj. Geneviève Darrieussecq....12
Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën komandantin e Gardës
Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Timothy Orr....12
Nënshkruhet Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Italisë....13
Ministri Berisha dhe ambasadori O'Connell nënshkruan vazhdimin e marrëveshjes së bashkëpunimit....13
Presidenti Hashim Thaçi dekoron gjenerallejtënant Rrahman Ramën me medaljen presidenciale....14
Presidenti Hashim Thaçi dekoron Agim Çekun me medaljen presidenciale....14
Ministri dhe komandanti pritën zëvendësshefin e Politikave dhe Planeve të ushtrisë së SHBA-ve për Evropë....14
Takimet e ministri të FSK-së Rrustem Berisha në Konferencën e Halifaksit....15
Takim i përbashkët i Ministrit dhe Komandantit të FKS-së me Zëvendës
Sekretaren e Përgjithshme të NATO-së znj. Rose Gottemoeller....15
Ministri Berisha takon senatoren amerikane Jeanne Shaheen....15
Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, qëndroi për vizitë në SHBA....16
Komandanti i Operacioneve Speciale të NATO-svizitoi Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së....16
Mbahet takimi i drejtorëve "Karta e Adriatikut –A5"....17
Ministri Rrustem Berisha mori pjesë në konferencën e ministrave të mbrojtjes
SHBA-Karta e Adriatikut në Mal të Zi....17
Ministri Rrustem Berisha merr pjesë në konferencën e ministrave të Mbrojtjes
"SHBA-Karta e Adriatikut-A5" në Kroaci....18
Ministri Rrustem Berisha merr pjesë në konferencën e ministrave të Mbrojtjes
"SHBA-Karta e Adriatikut-A5" në Kroaci....18
FSK-ja prezantoi të arriturat dhe sfidat në konferencën „Kosova e sigurt dhe e mbrojtur"....19
Në Pentagon dhe Uashington D.C takohen Grupet Punuese për Politika të Sigurisë SHBA-Kosovë....19
Delegacion i lartë i FSK-së vizitoi Qeverinë e Gjermanisë 20

Kosova dhe Italia thellojnë bashkëpunimin për siguri dhe mbrojtje....20
Zëvëndësministri Burim Ramadani dhe Komandanti i FSK-së Rrahman
Rama vizitë në Mbretërinë e Bashkuar....21
Sekretari i përgjithshëm në ,,Konferencën vjetore të NATO-s ”....21
Sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj qëndroi për vizitë në Mbretërinë e Bashkuar....22
Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama merr pjesë në
Konferencën Vjetore të Ushtrisë Amerikane për Evropë....22
FSK-ja parakalon në 10- vjetorin e shënimit të Pavarësisë së Kosovës....23
Në kazermën e FSK-së ,,Adem Jashari” në Prishtinë u mbajt ceremonia e 20-të vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”....24
Në nderim të “Epopesë së UÇK-së” ministri dhe komandanti i
FSK-së bënë homazhe te varri i Komandantit Legjendar Adem Jashari....25
Ministri Berisha dhe komandantiRama morën pjesë në manifestimin “Ditët e Shqipes”....25
Zhvillohet ceremonia e ndërrimit të komandës së Forcave Tokësore....26
FSK-ja mbajti ceremoninë e ndërrimit të komandës në KDS....26
FSK-ja përfundoi me sukses ushtrimin fushor ndërkombëtar “Shqiponja 6”....27
Ushtrimi i përbashkët “Shpata e Argjendtë 18” përfundoi operacionet stërvitore....28
FSK-ja mban punëtorinë ,,Ngritja e Kapaciteteve për Forcimin e Transparencës,
Përgjegjshmërisë dhe Integritetit në Sektorin e Sigurisë”....28
Pjesëtarët e FSK-së stërviten në Gjermani....29
Policia e FSK-së zuri vendin e tretë në garën për forcimin e ligjit....29
Diplomoi gjenerata 2018 e kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës....30
Në Akademinë e Mbrojtjes në Shkup diplomoi edhe një oficer i FSK-së nga radhët e komuniteteve....30
Diplomojnë rekrutët e rinj të FSK-së nga radhët e komuniteteve joshumicë....31
Ekipi i FSK-së fitoi medaljen e bronztë në garën e patrullimit ,, Cambrian Patrol”....31
Shpallet “Ushtari i vitit 2018” i garës së FSK-së dhe garës ndërkombëtare....32
Kadetët e FSK-së përfunduan me sukses ushtrimin fushor ,,Kampi veror 2018” në Krivollak....33
Gjenerata e re e kadetëve të FSK-së solemnisht dhanë betimin....33
Oficerët e FSK-së më të mirët në Mbretërinë e Bashkuar....34
Pjesëtarët e FSK-së më të mirët në garën ndërkombëtare të mjekësisëv....34
Toger Albert Asllani oficeri më i mirë ndërkombëtar në kursin “Kapiten i karrierës” në SHBA....35
FSK-ja pajiset me automjete taktike amerikane ,,Hamvi”....35
Gjermania i dhuroi FSK-së 44 automjete taktike dhe pajisje të tjera përcjellëse....36
Performojnë së bashku Bendi i Forcave Ajrore Amerikane dhe ai i FSK-së 36
Përurohet ura mobile e ndërtuar nga FSK-ja në Shqipëri....37
FSK-ja dhuroi qindra doza gjak për qytetarët e Kosovës....37
Komandanti i FSK-së merr pjesë në diplomimin e dy kadetëve në
Akademinë Ushtarake Mbretërore “Sundhurst”....38
Komandanti i FSK-së, dekoroi me medaljen ,,Shërbim vetëmohues” pjesëtarët e Kërkim-Shpëtimit....38
FSK-ja më e besueshmja për qytetarët e Kosovës....39
Zbulohet Pllaka përkujtimore në nderim të ushtarëve të NATO-s në Prishtinë....39
FSK –ja mbështet qytetarët e Komunës së Suharekës pas vërshimeve....40
Policia e FSK-së realizon trajnim në Bondsteel....40
Ushtari Alban Fazliu i dyti në Maratonën Kombëtare të Krosit në Shqipëri....41
FSK-ja mori pjesë në aksionin për “Ditën e Tokës”....41



www.mksf-ks.org

FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 75 • 04 Janar 2019 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

Kuvendi i Republikës së Kosovës votoi tri projektligjet për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës pas votimit në lexim të dytë, më datë 14 dhjetor 2018, miratuan me shumicë absolute të votave tri projektligjet bazë të FSK-së: Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në seancën solemne të mbajtur në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilën e kryesoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, ishin të pranishëm edhe presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri



Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, si dhe kadetë e oficerë të tjerë të FSK-së. Arsyetimin e raporteve me rekomandime për të tri projektligjet i paraqiti kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës, z. Haxhi Shala, i cili ftoi deputetët të votojnë projektligjet së bashku me amendamente.

Në një atmosferë festive, me 105 vota për, Kuvendi miratoi Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes së bashku me 11 amendamente, projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës me 45 amendamente dhe me 107 vota, si dhe miratoi Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me gjithsej 45 amendamente dhe me 107 vota për. Me aprovimin dhe pas hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve, FSK-ja merr mision ushtarak, kurse Kosova rrumbullakosi fazën e shtet-ndërtimit me institucionin më të rëndësishëm siç është Ushtria.

Presidenti dekreton ligjet që zyrtarizojnë krijimin e Ushtrisë së Kosovës



Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, mw 28.12.2018 në një ceremoni të organizuar në Presidencë, ka dekretuar tri ligjet bazë që e ndryshojnë mandatin dhe misionin e FSK-së. Ligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në ceremoninë solemne të organizuar me rastin e nënshkrimit të ligjeve për Ushtrinë e Kosovës ishte i pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe kadetë të FSK-së. Këto tri projektligje janë miratuar me shumicë votash nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 14 dhjetor 2018, ndërkaq me nënshkrimin e tyre nga Presidenti Thaçi, Kosova zyrtarisht u bë me ushtri.

Presidenti Hashim Thaçi si Komandant Suprem i Ushtrisë së Kosovës ka uruar ushtarët e Kosovës dhe aleatët ndërkombëtarë. „Ju uroj juve, i nderuar komandant, gjithë ushtarët, oficerët, nënoficerët dhe popullin e Kosovës. I falënderoj mbështetësit ndërkombëtarë, SHBA-të dhe të gjitha shtetet e tjera aleate në këtë ditë të rëndësishme të zyrtarizimit të Ushtrisë së Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi. Ndërsa para mediave, presidenti Thaçi ka deklaruar: "Me përgjegjësinë më të lartë shtetërore dhe me krenari, sot kam dekretuar ligjet që zyrtarizojnë krijimin e Ushtrisë së Kosovës. Dhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë dhe 20 vjet pas çlirimit, e bëmë ushtrinë tonë mbi të cilën përherë do të qëndrojnë nderi, siguria dhe mirëqenia e shtetit. Në dekadat e fundit kemi arritur ta përmbysim shekullin e shtypjes dhe ta projektojmë të ardhmen e sigurt të Kosovës evropiane. Por, e tërë kjo u bë e mundur vetëm falë sakrificës së shumë brezave që ishin gjithmonë udhërrëfyes për ne. Të qëndrojmë të bashkuar përpara çdo sfide, siç ishim të bashkuar për Ushtrinë e Kosovës, që t'ua sigurojmë një perspektivë më të mirë brezave të rinj!''

Kryeministri Haradinaj në natën e fundvitit viziton Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në

Me rastin e përfundimit të vitit kalendarik 2018, më 31.12.2018 Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës e vizitoi kryeministri i Republikës Ramush Haradinaj me bashkëpunëtorë. Në kazermën „Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, kryeministri u prit nga ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, zv. ministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Vizita e kryeministrit Haradinaj në FSK, ishte në kuadër të agjendës së tij, për të vizituar institucionet e Kosovës, që në ndërrimin e moteve punojnë, kur të tjerët festojnë. Para të pranishmëve kryeministri Haradinaj, u shpreh: „Me vizitën këtu, te



Ushtria e Kosovës i përmbylla vizitat e zhvilluara gjatë ditës. Vizitova zjarrfikësit, Policinë e Kosovës dhe tash Ushtrinë e Kosovës. Qytetarët e Kosovës mund të pushojnë të qetë. Ushtria e Kosovës është në detyrë edhe sonte". Në fund, kryeministri Haradinaj të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së ua uroi Vitin e Ri 2019.

Ministri Rrustem Berisha ka pritur në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralin Lorenzo D'Addario

Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Rrustem Berisha më 5 dhjetor 2018 ka pritur në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralin Lorenzo D'Addario. Në fillim, ministri Berisha i ka uruar detyrën e re komandantit të KFOR-it, gjeneralit D'Addario, si dhe i ka shprehur falënderim të veçantë për ndihmën e vazhdueshme që KFOR-it ka dhënë për FSK-në. Ministri Berisha, ndër të tjera tha se „ne jemi të hapur që bashkëpunimin tonë me KFOR-in ta avancojmë edhe më tej. Jemi të kënaqur me bashkëpunimin e deritashëm dhe do të vazhdojmë me këtë



bashkëpunim korrekt, të hapur dhe të sinqertë edhe në të ardhmen". Ministri Berisha, shtoi, se KFOR-i ka luajtur dhe po luan një rol të rëndësishëm për krijimin e një ambientit të qetë në Kosovë. „Roli juaj këtu, në krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, është shumë i rëndësishëm" -ka thënë ministri Berisha. Ministri Berisha e ka njoftuar gjeneralin D'Addario edhe me ecurinë e FSK-së, sukseset dhe sfidat me të cilat po përballet ajo. Po ashtu e ka njoftuar edhe lidhur me procesin e tranzicionit gjatë periudhës së pritjes për miratim të ligjeve të FSK-në në lexim të dytë nga Kuvendi i Kosovës. „Mandati i ri i FSK-së, do të ruajë karakterin profesional, me mision mbrojtës. Një Forcë e hapur për të gjithë qytetarët dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne jemi zotuar se rajoni do të ketë edhe një forcë aleate, të ndërveprueshme me aleatët dhe në shërbim të krijimit dhe ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë, jo vetëm si konsumuese por edhe si ofruese e paqes", ka shtuar në fund ministri Berisha. Ndërsa, komandanti i KFOR-it, gjenerali D'Addario, ka falënderuar ministrin Berisha për pritjen si dhe e ka përgëzuar për punën dhe përkushtimin e deritanishëm. „Jemi këtu që të kontribuojmë për sigurinë e qëndrueshme në Kosovë. Jam mirënjohës për gatishmërinë që po tregoni për bashkëpunim, në qëllimin e përbashkët për të krijuar siguri dhe paqe në vend", shprehet komandanti i KFOR-it, gjenerali D'Addario.

Komandanti i FSK-së priti ambasadorin e ri të SHBA-ve në Kosovë

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama më 13.12.2018 priti në vizitë ambasadorin e ri të SHBA-ve në Kosovë, z. Filip Kosnet (Philip Kosnett). Gjeneral Rama e falënderoi ambasadorin Kosnet për mbështetjen amerikane në të gjitha fazat, dhe e siguroi atë, se FSK-ja do të vazhdojë të jetë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe e besueshme. Bashkërisht diskutuan lidhur me procesin e ndërtimit gradual të aftësive të reja bazuar në misionin e ri. "Thellimi i bashkëpunimit të ndërsjellë do të vazhdojë edhe më tej, në ndërtimin e një Force profesionale, të edukuar dhe të trajnuar me standardet më të larta, për të qenë kontribuuese e sigurisë në vend dhe rajon. FSK-ja është faktor stabiliteti dhe do të vazhdojë të operojë në koordinim me KFOR-in dhe institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare. FSK-ja është institucion me vlera dhe si i tillë do të zhvillohet më tej bashkërisht me NATO-n dhe SHBA-të", u shpreh gjeneral Rama.



Komandanti i FSK-së priti komandantin e KFOR-it



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti sot në takim njohës komandantin e ri të KFOR-it, gjeneral majorin Lorenzo D'Addario. Gjeneral Rama së pari i uroi detyrën e re komandantit të KFOR-it gjeneralit Lorenzo D'Addario, dhe më pas e njoftoi me zhvillimet e fundit rreth miratimit të ligjeve për misionin të ri të FSK-së. Ai po ashtu e falënderoi për bashkëpunimin e vazhdueshëm në shumë fusha të NATO/KFOR-it me FSK-në. Gjatë takimit, të dy gjeneralët vlerësuan lart bashkëpunimin e FSK-së me KFOR-in.

Republika Çeke e mbështet Kosovën dhe FSK-në

Zëvendësministri i MFSK-së, Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 5 dhjetor 2018 qëndruan për një vizitë zyrtare në Republikën Çeke, ku janë pritur në Ministrinë e Punëve të Jashtme nga zv. ministri për Siguri dhe Çështjet Multilaterale Martin Povejshil dhe zv. ministri dhe drejtori i Departamentit për Evropën Jugore dhe Juglindore Martin Koshatka. Gjatë takimit të përbashkët, zv. ministri Ramadani i ka informuar zyrtarët e lartë çekë për procesin e tranzicionit të FSK-së në mandat ushtarak dhe mbrojtës, duke qartësuar objektivin e Qeverisë së Kosovës dhe procedurat e rregullta parlamentare për këtë proces. „Procesi i transicionit të FSK-së është legjitim, gradual dhe transparent, si dhe ndihmon në forcimin e angazhimit të marrëdhënieve në temat e sigurisë e të mbrojtjes midis shteteve në rajon. Kosova synon që të kthehet në ofrues të sigurisë rajonale dhe globale, përmes angazhimit aktiv në misione paqeruajtëse nëpër zona të konfliktit kudo nëpër botë, krah për krah me ushtritë e shteteve të NATO-s", tha z. Ramadani, duke nënvizuar qëllimin nacional të Kosovës, për anëtarësim në NATO.



Kurse, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, shpjegoi rrjedhën e procesit të transicionit të FSK-së, duke filluar nga zhvillimi i kapaciteteve trajnuese dhe të doktrinës. "Transicioni i FSK-së do të ketë tri faza të zhvillimit dhe do të realizohet në përputhje me planin afatgjatë, transparent dhe të koordinuar, në mënyrë që FSK-ja të vazhdojë të jetë institucioni shumetnik, profesional dhe model në vend dhe në rajon", ka thënë ndër të tjera gjenerali Rama.

Ndërsa, zv.ministri për Siguri dhe Çështjet Multilaterale, Martin Povejshil dhe zv.ministri dhe drejtori i Departamentit për Evropën Jugore dhe Juglindore, Martin Koshatka kanë shprehur mirëkuptimin e Republikës Çeke për procesin e tranzicionit të FSK-së, duke theksuar mbështetjen për thellimin e marrëdhënieve dypalëshe.

Ministri dhe komandanti i FSK-së bënë homazhe në Prekaz



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendësministri Agim Çeku, zëvendësministri Burim Ramadani si dhe një delegacion i gjerë nga MFSK-ja dhe FSK-ja, më 15.12.2018, bënë homazhe në varrezat e heronjve në Prekaz dhe në Marinë të Skenderajt.

Ministri Berisha së bashku me delegacionin e tij, së pari vendosën buqeta lulesh të freskëta te varri i komandantit legjendar Adem Jashari dhe te varret e familjarëve të familjes Jashari, si dhe vizituan të gjitha varret e të rënëve në kompleksin memorial ,,Adem Jashari'' në Prekaz.

Më pas, delegacioni i lartë i MFSK dhe FSK-së u pritën në odën e familjes Jashari nga z. Rifat Jashari dhe kryetar i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, të cilët i uruan krerët e Ministrisë së FSK-së për formimin e Ushtrisë së Kosovës. Gjithashtu edhe ministri Berisha dhe delegacioni i tij, uruan familjen Jashari duke ju shprehur nder dhe e lavdi për komandantin legjendar Adem Jashari dhe sakrificën sublime të familjes Jashari.

Ministri Berisha dhe komandanti Rama gjatë kësaj vizite u shoqëruan edhe nga sekretari i përgjithshëm, Shkelzen Sylaj, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, pastaj gjeneral major Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Irfete Spahiu, gjeneral Fadil Hadërgjonaj, gjeneral Naim Haziri, gjeneral Xhevahir Geci, gjeneral Skender Zhitia si dhe oficerë të tjerë të lartë të FSK-së. Ky ishte aktiviteti i parë i MFSK-së dhe FSK-së pas votimit në Parlamentin e Kosovës të projektligjeve për tranzicionin e FSK-së.

Ministri Rrustem Berisha priti myftiun Naim Tërnava



Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, më 26.12.2018 priti në takim kreun e Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiun Naim Tërnava. Myftiu Tërnava pasi e falënderoi ministrin për pritjen, shprehu edhe gëzimin e tij që Kosova arriti të formojë ushtrinë, e cila siç tha ai "është garanci e fortë për paqen dhe sigurinë e vendit tonë dhe rajonit". Ai po ashtu tha se BIK-u ka kontribuar në të kaluarën dhe do të vazhdojë të kontribuojë për forcimin e ushtrisë. "Zoti ju ndihmoftë në rrugën tuaj për ndërtimin e kapaciteteve të plota ushtarake. Na ka gëzuar pa masë edhe përkrahja e miqve tanë ndërkombëtarë në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë dhe miqtë tjerë të shtetit tonë",- u shpreh myftiu Tërnava. Ministri e falënderoi Myftiun Tërnava për vizitën, duke thënë se "kjo vizitë është shumë domethënëse dhe do t'i shërbejë zhvillimit dhe ecjes përpara të proceseve shtet-formuese të Kosovës dhe se roli i BIK-ut është shumë i rëndësishëm për paqen dhe sigurinë në Kosovë".

Ministri Berisha theksoi se ushtria e Kosovës do të jetë forcë paqësore që do t'iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve që jetojnë në Kosovë.

Në MFSK mbahet takimi me gazetarë në prag të përfundimit të vitit 2018

Në mjediset e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në prag të përfundimit të këtij viti kalendarik, më 28.12.2018, u mbajt një takim me gazetarë dhe përfaqësues të mediave, të cilët kanë përcjellë aktivitetet e MFSK/FSK-së gjatë gjithë vitit që po e lamë pas. Në takimin me gazetarë ishin të pranishëm: zëvendësministri Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralë Gëzim Hazrolli, gjeneral Naim Haziri, si dhe oficerë dhe zyrtarë të informimit të Ministrisë dhe të FSK-së. Në emër të Departamentit për Marrëdhënie me Publikun të pranishmit i përshëndeti drejtori Ibrahim Shala, ndërsa në emër të ministrit Berisha zv. ministri Burim Ramadani, i cili tha. „Kam kënaqësinë, që në emër të ministrit, Rrustem Berisha, t'ju uroj për një vit me plotë angazhime, detyra, sfida e zhvillime të mëdha. Kjo përmbyllje e vitit, sigurisht se është më e veçantë dhe më e suksesshme për Ministrinë tonë, për Forcën tonë, për Kosovën dhe për partnerët tanë po ashtu. Mandatimi ushtarak i Forcës sonë–Ushtrisë sonë–është një sukses që i tejkaloi sfidat, me përkushtim dhe shpeshherë edhe me kryeneçësi të argumentuar. Vendime të këtilla, si miratimi i ligjeve më 14 dhjetor 2018, ndodhin një herë në jetën e një shteti. Prandaj, është e qartë se ky vit mund të cilësohet edhe si Viti i Ushtrisë. Tash në përmbyllje të vitit, e shoh se gjendja nuk ka qenë e lehtë në fillim të 2018. Por, kjo ka ndryshuar me plan e aktivitete të detajuara dhe me përkushtim të madh. Njëkohësisht, përkrahja nga partnerët strategjikë ka qenë dhe mbetet e madhe. Kemi prezantuar arritjet e Forcës dhe planet e Kosovës në shumë kryeqytete të vendeve



të NATO-s, prej të cilave kemi marrë mbështetje vazhdimisht. Ne u jemi mirënjohës SHBA-ve dhe vendeve partnere të NATO-s e të BE-së, vendeve të rajonit po ashtu, për mbështetje të plotë. I jemi mirënjohës KFOR-it dhe NALT-it për punën në Kosovë. Tash, anëtarësimi në NATO është synimi ynë. Unë pres dhe jam i bindur që Kosova do të jetë vendi i 31-të i NATO-s. Kjo mbetet puna jonë dhe sfida jonë për vitet e ardhshme. Të nderuar, me lejoni që edhe juve, gazetare e gazetarë, t'ju uroj krijimin e Ushtrisë së re të Kosovës, sepse ajo është e gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallime profesioni, gjinie apo etnie. Për arritjen e këtij suksesi historik për shtetin tonë, dua që në emër të ministrit Berisha t'ju falënderoj për bashkëpunimin e mirë të deritashëm secilin prej jush, për kontributin që keni dhënë në shpërndarjen, shfaqjen, prezantimin e aktiviteteve dhe sukseseve të FSK-së në publik. Ne kujtojmë me respekt dhe përulje të gjithë kontribuuesit për këtë sukses, të cilët nuk janë më në mesin tonë. Atdhetarët dhe profesionistët, dëshmorët dhe martirët që nuk kanë kursyer asgjë – as jetën e tyre – për suksesin e Kosovës! Urime Vitin e Ri 2019! Gëzuar!''

Gjatë këtij kokteji, gazetarët patën rastin të bisedojnë për të arriturat dhe bashkëpunimin e ndërsjellë.

Diplomon piloti i parë i FSK-së

Nëntogeri i FSK-së, Afrim Zabeli, më 13 dhjetor 2018 ka diplomuar në Shkollën e Aviacionit Tokësor të Turqisë, duke u bërë piloti i parë i helikopterëve në kuadër të Forcës së Sigurësë të Kosovës. Nëntoger Zabeli, në mesin e 26 oficerëve të tjerë pjesëmarrës të këtij trajnimi u shpall njëri ndër tre më të mirët. Në ceremoninë e diplomimit mori pjesë edhe gjeneral brigade Naim Haziri, komandant i Brigadës së Mbështetjes së Operacioneve. Gjeneral Haziri u prit nga komandanti i shkollës, gjeneral brigade Nadir Gündüz i cili i shprehu kënaqësinë e tij, gjeneral Hazirit, për bashkëpunimin e deritanishëm të ushtrisë turke me Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ai po ashtu premtoi se shkolla e tij, është e gatshme që të trajnojë edhe pilotë të tjerë të rinj nga radhët e FSK-së. Ndërkaq, gjeneral Haziri, tha se „është një ndjenjë e veçantë krenarie diplomimi i pilotit të parë të FSK-së. Sukseset e panumërta të FSK-së, dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të saj, tashmë e përfshijnë edhe pilotin e parë të FSK-së, nëntogerin Afrim Zabeli“. Në Shkollën e Aviacionit Tokësorë në Turqi, janë duke i vijuar mësimet edhe dy nëntogerë të tjerë të FSK-së, Atdhe Hasani dhe Krenar Voca. Gjeneral Haziri, në emër të FSK-së e përgëzoi pilotin Afrim Zabeli për përkushtimin dhe profesionalizimin e treguar gjatë trajnimit në Turqi, ndërsa dy pilotëve të ardhshëm, Atdhe Hasanit dhe Krenar Vocës, ju dëshiroi diplomim sa më të shpejtë.

Diplomimi i pilotit të parë, është njëri ndër sukseset më të rëndësishme të Forcës së Sigurisë të Kosovës.



Kapiteni Bujar Ferizi nderohet me dy çmime në shkollën ushtarake në SHBA



Pjesëtarët e FSK-së, kudo që po marrin pjesë në trajnime dhe shkollime jashtë vendit, po arrijnë rezultate të shkëlqyeshme. Njëri ndër ta është edhe kapiten Bujar Ferizi, shef i Qendrës së Operacioneve në Forcën e Sigurisë së Kosovës, i cili ka përfunduar me sukses trajnimin „Kursi i kapitenëve për mbrojtje kimike“, në shkollën e Mbrojtjes Kimike- Atomike dhe Biologjike (MKAB) në Fort Leonard Wood, në shtetin Missouri, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky kurs ka filluar më 10 korrik dhe ka përfunduar më 07 dhjetor 2018.

Oficeri i FSK-së, kapiteni Bujar Ferizi, gjatë shkollimit 22 javor në shkollën e MKAB-së në SHBA, për paraqitje të dalluar akademike është nderuar me çmimin „Student Ndërkombëtar Nderi, kurse për rezultate të shkëlqyera në testin fizik ka marr çmimin „Njeriu i Hekurt“.

Kursi për kapiten të karrierës përfshin përgatitjen e përgjithshme të oficerëve në fushën e MKAB-së, në aftësi udhëheqëse, teknike dhe taktike luftarake, procedura shtabore, doktrina të gjinive të kombinuara të ndërlidhura me procesin e vendimmarrjes ushtarake, punë grupore dhe aftësim në operacionet e detektimit dhe dekontaminimit të materieve kimike-atomike-biologjike dhe nukleare.

Kapiten Ferizi, është oficeri i parë nga Kosova i cili përfundon trajnimin e mbrojtjes nga helmet kimike, atomike, biologjike dhe nukleare të nivelit Kapiten karriere, në „United States Army CBRN School“.

Dy kadetë të FSK-së diplomohen në Akademinë Ushtarake të Gjermanisë

Kadetët e FSK-së, Art Sahiti dhe Dhurim Shemsedini, ditë më parë u diplomuan në Akademinë Ushtarake ,,Bundeswehr –OffizierLehrgang” të Republikës Federale të Gjermanisë.

Kadetët e FSK-së i kanë përfunduar me sukses studimet trevjeçare në Akademinë Ushtarake më prestigjioze për logjistikë në Gjermani, ku edhe janë graduar në gradën nëntoger. Nëntogerët, Art Sahiti dhe Dhurim Shemsedini, pas kryerjes së Akademisë Ushtarake janë emëruar në detyra të reja në Brigadën e Mbështetjes Operacionale, në Departamentin e Logjistikës, pasi që edhe studimet i kanë mbaruar në këtë fushë. Të dy nëntogerët e sapoemëruar në detyrë, u shprehen të kënaqur dhe shumë mirënjohës ndaj FSK-së që ju ofroi mundësinë për të studiuar në një shtet mik dhe të fuqishëm si Gjermania, e cila vazhdimisht ka kontribuar për Kosovën dhe në veçanti për FSK-në, duke e ndihmuar në të gjitha fushat si në fushën e arsimimit, trajnimeve, logjistikës (pajisje logjistike), mjekësore (pajisje mjekësore), transportit etj.

Akademia ,,Bundeswehr–OffizierLehrgang” në Gjermani është e njohur për cilësinë e lartë të shkollimit në nxjerrjen e kuadrove profesionale dhe specialistike në degë të ndryshme ushtarake dhe në logjistikë.



Nënkoloneli Zejnullahu kreu me sukses trajnimin „Blerjet ndërkombëtare për mbrojtje” në SHBA



Nga data 10 deri më 23.11.2018 nënkoloneli Mentor Zejnullahu, shef i Sektorit për Plane dhe Programe në Departamentin e Logjistikës në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ka marrë pjesë në trajnimin „Negociatat në blerjet ndërkombëtare për mbrojtje“ në Naval Postgratuade School në Monterey të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Fokusi i këtij kursi/trajnimi ka qenë „përgatitja për procesin e negocimit, duke filluar nga plani për negocim me të gjitha elementet brenda tij, e deri te vetë akti i negocimit gjatë blerjeve ushtarake ndërkombëtare“. Nënkoloneli Mentor Zejnullahu tha se „njohuritë e fituara nga pjesëmarrja në këtë kurs/trajnim janë të dobishme si në aspektin profesional ashtu edhe në atë praktik. Përgatitjet për proceset e negociatave gjatë blerjeve të planifikuara për të ardhmen në institucionin tonë, do t’i përcjelli edhe tek zyrtarët tjerë të Ministrisë dhe FSK-së“.Oficerët e FSK-së, kudo ku kanë marrë pjesë; qoftë në trajnime, shkollime apo gara të ndryshme jashtë vendit kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme.

Kapiteni Besnik Thaçi kreu Kursin përv mbrojtje kimike, biologjike, radiologjike dhe atomike në Turqi

Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, kapiteni Besnik Thaçi, ka përfunduar me rezultat të shkëlqyeshëm trajnimin 5-javor „Kursi i Oficerit për Mbrojtje Kimike, Biologjike, Radiologjike dhe Atomike" të ushtrisë turke, të mbajtur në qytetin e Konyas në Turqi.

Kapiten Thaçi, në bazë të të arriturave teorike dhe praktike gjatë trajnimit, është radhitur i treti, nga të gjithë pjesëmarrësit vendorë dhe ndërkombëtarë që kanë marrë pjesë në këtë trajnim. Trajnimi specialistik ka filluar nga data 05.11.2018 dhe ka përfunduar më 07.12.2018, dhe është mbajtur në Shkollën specialistike për mbrojtje kimike, biologjike, radiologjike dhe atomike në Konyas.

Trajnimi për detektimin dhe mbrojtjen ndaj armëve kimike, biologjike, radiologjike dhe atomike është realizuar në teori dhe në praktikë me pajisje të ushtrisë turke. Në këtë trajnim, përveç nënoficerëve të forcave ajrore turke, kanë marrë pjesë edhe oficerë me gradën nëntoger e deri te grada kolonel të gjinive të ndryshme ushtarake



turke. Gjithashtu pjesëmarrës kishte oficerë edhe nga Azerbajxhani, Kosova e vende të tjera. Shkolla specialistike për mbrojtje kimike, biologjike, radiologjike dhe atomike është shkolla e vetme në Republikën e Turqisë dhe në rajon për këtë fushë ushtarake dhe konsiderohet si njëra ndër shkollat më cilësore në fushën e mbrojtjes KBRA.

Pjesëmarrja e kapitenit të FSK-së, Besnik Thaçit, ka shënuar bashkëpunimin e parë në këtë fushë të ofruara nga Republika e Turqisë.

Tashmë në këtë shkollë janë ofruar edhe vende të reja për pjesëmarrjen e nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së, duke shënuar kështu bashkëpunim të rëndësishëm të FSK-së me ushtrinë turke.

Qendra për Studime Universitare e FSK-së mbajti debatin „Forumi i Sigurisë"



Në ambientet e kazermës „Adem Jashari" në Prishtinë, më 7 dhjetor, nën organizimin e Qendrës për Studime Universitare (QSU) në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së është mbajtur „Forumi i Sigurisë", edicioni i I, me temë "Nataliteti dhe Migrimi 2019-2035 dhe efektet afatgjata në aspektin e sigurisë në Kosovë". Punimet e Forumit i shpalli të hapura komandanti i QSU-së, major Vegim Krelani i cili paraqiti qëllimin e forumit dhe synimin që edicionet tjera të Forumit të Sigurisë të kthehen në mekanizma të rregullta të diskutimit akademik në nivel të FSK-së.

Në këtë edicion të Forumit të Sigurisë, të ftuar si panelist ishin prof. Dr. Armend Muja i cili prezantoi tezën "Nataliteti dhe Emigrimi" si dhe major Korab Dauti i cili prezantoi temën „Emigrimi dhe pasojat për FSK-në". Në këtë forum pjesëmarrës ishin oficerët dhe nënoficerët e të gjitha njësive të FSK-së, partnerë ndërkombëtarë, stafi i QSU-së dhe kadetët e vitit të IV-të.

Qëllimi i forumit ishte njohja me trendët e emigrimit në Kosovë, ndikimi i emigrimit në sigurinë afatgjate si dhe efektet e emigrimit në FSK. Të gjithë pjesëmarrësit kontribuuan me pyetjet dhe komentet e tyre në arritjen e qëllimit të forumit. Me rastin e përfundimit të forumit, panelistëve: Prof. Dr. Armend Muja dhe major Korab Dautit iu ndanë mirënjohje në emër të komandantit të KDS-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu, në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë në realizimin e forumit. Forumi është vlerësuar si mjaft pozitiv, dhe se forume të tilla do të vazhdojnë të organizohen edhe në të ardhmen me qëllim të ngritjes për diskutim të temave të rëndësishme për FSK-në.

FSK-ja bëhet me helikopter për qëllime trajnimi

Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në Regjimentit të Mbrojtjes Civile i FSK-së, në Pomozotin, zyrtarisht zbulon helikopterin-kornizë, që do të përdoret për qëllime të trajnimeve për kërkim-shpëtim. Prerjen e shiritit e kanë bërë komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri dhe drejtori i QTKSH-së, z. John Doone. Korniza e helikopterit do të përdoret në skenarë të ndryshme për zhvillimin e disa trajnimeve; përfshirë këtu një aksident helikopteri me viktima brenda tij, një helikopter në ngritje me viktima përbrenda, një helikopter në ulje me viktima në të dhe një ekip mjekësor të gatshëm për të ofruar ndihmë në rast nevoje. Shumë skenarë tashmë janë testuar gjatë trajnimeve të ndryshme të kërkim-shpëtimit, ndërkaq gjatë vitit 2019 do të fillojnë trajnime, në veçanti, lidhur me helikopterë. E veçanta e këtij helikopteri është se, i tëri sistemi është ndërtuar nga vet stafi i Qendrës së Trajnimit të Kërkim-Shpëtimit dhe është përdorur materiali i ricikluar i gjetur brenda kampit. Korniza e helikopterit ka një gjatësi prej 23 m, me 3 m gjerësi dhe me rreth 3 m lartësi. Pesha totale e tij është diku rreth 12 tonë. Është i ngjyrosur me ngjyra kamuflazhi, me emblemë të Kryqit të Kuq në të dyja anët dhe ka përmasa dhe pamje të një helikopteri të vërtetë. Përbrenda ka dy ulëse për pilot, 6 ulëse me komplet pajisje për udhëtarë, dhe 6 shtretër për viktima. Për qëllime trajnimi, pjesës qendrore të helikopterit mund t'i vihet zjarri dhe sërish struktura e helikopterit do të mbetet e padëmtuar.

E gjithë puna e planifikuar është kryer nga stafi dhe është mbështetur nga RMC-ja, gjatë kohës së trajnimeve të



QT-së, në mbrëmje apo edhe gjatë vikendeve. Koha e paraparë për ndërtim ishte 4 javë. Kostoja materiale e gjithë projektit ishte €105.00.

QT e RMC–së tani ofron një objekt trajnues që asnjë institucion tjetër trajnues vendor e ndërkombëtar në Kosovë nuk mund ta ofrojë. Gjithashtu, QT-ja do të ofrojë mundësi trajnuese të tjera në bashkëpunim me partnerët rajonalë dhe ata ndërkombëtarë.

Mbahet konferenca dyditore e nënoficerëve të FSK-së

Në kazermën „Adem Jashari" në Prishtinë, për dy ditë rresht nga 26-28.12.20180 i ka zhvilluar punimet konferenca e nënoficerëve të FSK-së, bazuar në planin vjetor të aktiviteteve të korit të nënoficerëve të FSK-së. Konferenca e nënoficerëve të FSK-së ka për qëllim përmbledhjen e punës së kanalit mbështetës të nënoficerëve gjatë vitit 2018, si dhe hapat që duhen bërë në të ardhmen. Në konferencën e nënoficerëve kanë marrë pjesë shumë personalitete të njohura nga fusha e artit, kulturës dhe fusha të tjera. Në hapjen e konferencës, rreshter majori i Komandës së Forcave Tokësore Fetah Zejnullahu foli për rëndësinë që ka kjo konferencë për korin e nënoficerëve, vlerësimin e punës së tyre, si dhe shkëmbimin e përvojave me personalitete të profesioneve të ndryshme të Kosovës.

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pasi përshëndeti pjesëmarrësit, foli për rrugën, sfidat dhe të arriturat e përgjithshme. Në konferencë, në cilësinë e mysafirëve ishin: rreshter majori i FSK-së Genc Metaj, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës Enver Peci, këngëtarët Kreshnik Fazliu-MC Kresha dhe Festim Arifi –Lyrical Son, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, kampionia e Botës Majlinda Kelmendi, trajneri Driton Kuka, ministri i Financave Bedri Hamza, gazetarët Shkumbin Ahmetxhekaj dhe Jehona Zhitia etj.

Pjesëmarrësit përgjithësisht folën për eksperiencat e tyre në jetë, vështirësitë dhe sfidat që kanë kaluar për të arritur atë të cilën ata kanë dëshiruar. Kjo ishte një përvojë e mirë për pjesëmarrësit e korit të nënoficerëve të të gjitha njësive të FSK-së.

Gjatë konferencës pati pyetje të shumta nga nënoficerët drejtuar mysafirëve, dhe në fund fare, për pjesëtarët e FSK-së të cilët kanë arritur maksimumin e pikëve të kërkuara sipas kritereve të testimit është realizuar ceremonia e Bexhit të Fitnesit Fizik.

Presidenti Thaçi drekon së bashku me ushtarët e FSK-së

Presidenti i Republikës së Kosovës, njëherësh Komandant Suprem i Ushtrisë së Kosovës, Hashim Thaçi, më 24.12.2018 vizitoi kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së në Prishtinë, ku u prit nga komandanti i saj, gjenerallejtënant Rrahman Rama, si dhe nga ushtarë, oficerë dhe gjeneralë të FSK-së.Me këtë rast, Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë së Kosovës, Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë drekës u kanë



shërbyer ushqimin ushtarëve dhe oficerëve të FSK-së si dhe kanë drekuar bashkë me ta.Pas drekës, presidenti i Kosovës, Z. Thaçi, para përfaqësuesve të mediave, u shpreh i kënaqur për hapin e madh që është bërë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ku edhe një herë u verifikua botërisht themelimi i ushtrisë së Kosovës.” Sot jam këtu për t’ju shërbyer ushtarëve të Kosovës, në një drekë të përbashkët, me këtë rast i urojë të gjithë pjesëtarëve festat e fundvitit, duke ju uruar shëndet atyre dhe familjeve të tyre. Unë si president i Republikës së Kosovës, kam vendosur që t’i propozojë Qeverisë së Republikës së Kosovës ngritjen e pagave për FSK-në, që nënoficerët dhe oficerët të kenë një jetë më me dinjitet në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe shpresoj se Qeveria do t`i përgjigjet pozitivisht kërkesës sime për rritjen e pagave“, tha në fund, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

Komandanti i FSK-së gjenerali Rrahman Rama ndau dhurata për fëmijët e Klinikës së Pediatrisë

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me ministrin e Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, më 24.12.2018 kanë vizituar fëmijët e shtrirë në Klinikën e Pediatrisë të QKUK-së në Prishtinë, ku u pritën nga drejtoresha e Klinikës, Drita Telaku-Qosaj dhe stafi mjekësor i kësaj klinike. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama dhe ministri Ismaili, me rastin e festave të fundvitit iu dhuruan dhurata fëmijëve të shtrirë në këtë klinikë, duke ju dëshiruan shërim sa më të shpejtë dhe duke ju uruar që Krishtlindjet dhe Vitin e Ri t’i festojnë së bashku me familjarët e tyre.
Ky aktivitet i FSK-së është organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.



Pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë trajnohen në Qendrën e Kërkim-Shpëtimit Urban të FSK-së



Në kuadër të bashkëpunimit të FSK-së me FA të Shqipërisë, nga data 09-21 dhjetor 2018, në kazermën „Evropianet e Rinj“ në Pomozotin, u zhvillua trajnimi për „Kërkim-Shpëtim-Urban, Niveli Bazik“, në të cilin kanë marrë pjesë 14 pjesëtarë të FASH-së. Në ceremoni morën pjesë: drejtori i DO-së në MFSK, gjenerali Gëzim Hazrolli, atasheu ushtarak i Shqipërisë, koloneli Eduard Bala, komandanti i BMO-së, gjenerali Naim Haziri, komandanti i RMC-së, koloneli Shaip Haziri, drejtori i QTKSH-së, John Doone, si dhe oficerë të FSK-së dhe të FARSH-së. Gjeneral Hazrolli, në fjalën e tij, tha se ky është një moment i veçantë për ne, për Qendrën e Regjimentit dhe për FSK-në. Duke iu drejtuar pjesëtarëve të FARSH-së, ai tha: „ne kemi arritur që t’ju ofrojmë trajnime, por mbi të gjitha një eksperiencë të mirë si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Unë jam shumë i sigurt, që gjatë kohës së trajnimit keni pasur mundësi të jashtëzakonshme që t’i merrni ma të mirat nga instruktorët e FSK-së. Synimi ynë është që kjo qendër të bëhet një qendër ekselence, dhe jam i sigurt që nuk do t’i mungojë as gjë, nga qendrat tjera të NATO-s“. Ndërsa, kolonel Bala, falënderoi FSK-në për bashkëpunimin dhe trajnimin e zhvilluar për ushtarët e FA SH-së, ai njëherësh vlerësoi lart nivelin e trajnimit dhe eksperiencën e instruktorëve të FSK-së. Gjithashtu, ky specializim është jashtëzakonisht i nevojshëm jo vetëm për mbrojtjen tonë, sepse një nga elementet kryesor është siguria e jetës së qytetarëve, tha në fund koloneli Bala. Ndërkaq, drejtori i QTKSH-së John Doone theksoi se të gjitha trajnimet në QTKSH vlerësohen jo vetëm nga aspekti specialistik, por edhe për nga qëndrimi dhe karakteri që tregojnë pjesëtarët gjatë kursit. Vlerësimi i kursantëve u bë në bazë të angazhimit të tyre gjatë këtyre ditëve dhe shkallës së njohurive teorike dhe praktike, që ata kanë arritur të fitojnë nga ky trajnim. Qëllimi i këtij trajnimi është mirëmbajtja e njohurive ekzistuese si dhe avancimi dhe ngritja profesionale e tyre.

FSK-ja mban ligjërata për vetëdijesimin nga rreziku i mjeteve piroteknike

Tashmë që po afrohen festat e fundvitit, përdorimi i mjeteve piroteknike nga ana e të rinjve në Kosovë është rritur me të madhe. Forca e Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit nëpër komuna, ka organizuar fushatë vetëdijesimi nëpër shkollat fillore të Kosovës me qëllim të ndërgjegjësimit të nxënësve për rrezikun që mund të shkaktojë përdorimi nga ana e tyre i mjeteve piroteknike. Fushata është realizuar nga data 10 deri më 19 dhjetor 2018 dhe janë përfshirë nxënës të shkollave fillore të Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Ferizajt, Gjilanit dhe Dragashit. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 17 orë mësimi ku kanë marrë pjesë mbi 1000 nxënës. Ligjëratat janë mbajtur nga instruktorët e Kompanisë së Deminimit, të cilët janë të përgatitur dhe të trajnuar për mjete të rrezikshme. Nxënësit shfaqen interesim të madh gjatë këtyre ligjëratave, gjë që u pa edhe nga pyetjet e tyre të shumta rreth këtyre mjeteve. Vlen të ceket se një numër i madh i tyre ishin mjaft të zëshëm kundër përdorimit të tyre. Instruktorët ligjërues të angazhuar në këtë aktivitet, rreshter Valon Abdyli, tetar Butrint Kastrati, tetar Liridona Musaj, tetar Shpejtim Gashi, shprehen mjaft të kënaqur me interesimin e nxënësve dhe angazhimin e personelit të shkollave ku janë realizuar këto ligjërata.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama mbajti ligjëratë para studentëve të Universitetit „ISA BOLETINI“ në Mitrovicë

Në Universitetin „Isa Boletini“ në Mitrovicë, në organizim të Fakultetit Juridik më 26.12.2018 komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, para studentëve dhe stafit akademik mbajti një ligjëratë me temën: Të arriturat e përgjithshme të FSK-së, transformimi si dhe e ardhmja e FSK-së. Gjeneral Rama, me këtë rast, përshëndeti studentët dhe stafin akademik duke ju uruar aprovimin e tri ligjeve bazë për transformimin e FSK-së dhe Ministrinë e Mbrojtjes, dhe njëherazi falënderoi për angazhimin ushtarët dhe oficerët e të FSK-së, partnerët strategjikë, veçanërisht SHBA-të, me theks të veçantë ata të cilët kontribuuan më së shumti për të ardhur kjo ditë; dëshmorët e rënë, familjet e dëshmorëve dhe luftëtarët e UÇK-së. Duke falënderuar për kontributin e të gjithë aktorëve relevantë dhe parlamentarët për aprovimin e tri ligjeve, gjeneral Rama, theksoi se ''qëllimi dhe synimi ynë, është ta ndërtojmë një forcë që është në shërbim të të gjithë qytetarëve tanë. Synimi ynë është që FSK-ja me mision të ri, në të ardhmen të jetë forcë paqeruajtëse''. Gjeneral Rama, më tej, shtoi se ''nuk është qëllimi ynë ta rrezikojmë dikë, dhe mbi bazën e këtij parimi, këto dy vitet e fundit kemi pasur angazhim të madh njoftues nëpër kryeqytetet më të mëdha evropiane, ku qëllimi dhe synimi ynë ishte njoftimi për së afërmi me procesin e transformimit të FSK-së. Objektiv ynë është të jemi pjesë e strukturave të NATO-s, dhe jemi duke e ndërtuar FSK-në mbi bazën e standardeve të NATO-s''.

Duke folur për shkollimin, trajnimet e pjesëtarëve të FSK-së, gjeneral Rama tha se ''djemtë dhe vajzat e FSK-së, kudo që kanë marrë pjesë kanë qenë më të mirët'', duke numëruar shtetet si: SHBA-të, Gjermaninë, Mbretërinë e Bashkuar, Maqedoninë, Kroacinë, Turqinë, Shqipërinë etj. ''



Këto rezultate janë arritur vetëm falë përkushtimit, disiplinës dhe punës këmbëngulëse. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me NATO-n Ne kemi një ekip Këshillues në FSK, me të cilët bashkëpunojmë ngushtë dhe çdo gjë e bëjmë mbi bazën e standardeve të NATO-s. Me NATO-n/KFOR-in, marrim pjesë në ushtrime të përbashkëta të cilat mbahen nga KFOR-i ose nga FSK-ja. Ne jemi shumë mirënjohës për ndihmën e NATO-s dhe KFOR-it''.

Në fund, studentët dhe stafi akademik i universitetit i parashtruan shumë pyetje komandantit të FSK-së, që kishin të bënin me inkuadrimin e të rinjve në radhët e FSK-së, me mundësitë e shkollimit, trajnimit dhe perspektivën.

Gjenerali Enver Cikaqi vizitoi kursantët e trajnimit „Evakuimi në kushte të vështira malore”



Më 29 nëntor 2018 ka filluar realizimi i trajnimit „Evakuimi në kushte të vështira malore”, me instruktorë të shkollës luftarake malore, nga shteti i Vermontit, SHBA. Trajnimi është duke u realizuar dhe koordinuar nga Qendra e Trajnimit e Kërkim-Shpëtimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, mbështetur nga instruktorët e Kërkim-Shpëtimit dhe në bashkëpunim me instruktorë nga SHBA-të.

Në këtë trajnim po marrin pjesë 32 pjesëtarë nga FSK-ja, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, Forcat e Armatosura të Republikës së Maqedonisë dhe të Republikës së Bullgarisë. Trajnimi po realizohet në pjesën malore në mes Prizrenit dhe Dragashit; në një territor i cili i plotëson kriteret për realizimin e një trajnimi të tillë, dhe i cili është i nevojshëm për përgatitjen e njësiteve të cilat në vazhdimësi janë në aktivitetet e tyre në terrene të vështira, siç është Policia Kufitare e Kosovës dhe Kërkim-Shpëtimi i FSK-së

Komandanti i Forcave Tokësore, gjenerali Enver Cikaqi, përcolli nga afër procedurat e punës në tërheqjen e viktimave nga terrenet e thyera malore dhe vështirësitë me të cilat përballet personeli në këto situata, me këtë rast, gjeneral Cikaqi, u bë edhe vet pjesë e këtij trajnimi duke ndihmuar në tërheqjen e një viktime nga një thellësi në një mjedis të vështirë malor. Komandanti i KFT-së, gjeneral Cikaqi, falënderoi instruktorët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për kontributin e dhënë në të gjitha fushatë, në ngritjen profesionale të personelit të FSK-së, po edhe të agjencive të sigurisë në Kosovë dhe më gjerë.

Gjeneral Cikaqi, tha se: „rëndësia e këtij trajnimi ka bërë bashkë të gjitha agjencitë e sigurisë po edhe partnerët nga Maqedonia dhe Bullgaria. Më gëzon fakti, për punën tuaj të përbashkët si grup, këto kapacitete të krijuara, ne do t'i ruajmë edhe në misionin e ri në të ardhmen, Njësia jonë e Kërkim-Shpëtimit na ka bërë krenar me punën dhe aktivitetin e saj, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Duke i parë kushtet, ku ju jeni duke e realizuar këtë trajnim, që është shumë sfidues, tregon për përkushtimin tuaj për të mësuar sa më shumë nga përvojat e partnerëve tanë të cilët kanë marrë një rrugë të gjatë nga Vermonti i SHBA-ve, për të trajnuar dhe përgatitur pjesëtarët tanë”.

Instruktorët amerikanë ishin magjepsur me përkushtimin e secilit kursantë, për të nxënë sa më shumë njohuri dhe për të arritur përvoja sa më të mira, që këto përvoja t`i përdorin në rastet reale në jetën dhe punën e tyre të përditshme.

FSK-ja mbështeti projektin humanitar me moton „Unë ty, dashuri në pako“

Nën organizimin dhe përkujdesjen e Ministrisë për Forcën e Sigurisë dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, përkatësisht Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak, në prag të festave të fundvitit, është mbështetur projekti me moton „ Unë ty, dashuri në pako“. Për mbledhjen dhe shpërndarjen e afro 4000 dhuratave, të grumbulluara nga nxënësit e shkollave të Prishtinës, e që të njëjtat më pastaj janë shpërndarë te moshatarët e tyre në shkollat e fshatrave të rrethit të Prishtinës, FSK-ja ofroi mbështetje logjistike, transport dhe mbështetje me personel. Projekti me moton “Unë ty, dashuri në pako” është realizuar nga fondacioni „Mute“ në bashkëpunim me MFSK-në dhe Drejtorinë për Arsim të Komunës së Prishtinës. Aksioni i FSK-së është shtrirë në 15 shkolla dhe në katër shoqata: REA, Fushë-Kosovë; Fëmijët jetim dhe të varfëritë, në kuadër të Komunës së Fushë Kosovës, shoqata „AUTIZMI“ dhe Shoqata „Nëna dhe fëmijët e lumtur“



Pjesëtarët e FSK-së trajnohen për logjistikë nga njësia turke

Nga data 18-22. 2018, në kazermën „Sulltan Murati“ në Prizren, u mbajt trajnimi/seminari për logjistikë nga Njësia Trajnuese Turke. Në kuadër të këtij trajnimi/seminari kanë marrë pjesë pesë (5) pjesëtarë të MFSK/FSK-së, të cilët i kanë perfeksionuar njohuritë e tyre në lëmin e logjistikës. Tema e këtij trajnimi/-seminari ishte:„ Sistemi i menaxhimit të logjistikës dhe kurset e furnizimit“. Pas përfundimit të trajnimit/seminarit, instruktorët e ushtrisë turke u ndanë shumë të kënaqur me arritjet e përgjithshme të pjesëtarëve



të MFSK/FSK-së. Njësia Trajnuese Turke premtoi se edhe në të ardhmen do të vazhdojë bashkëpunimin për logjistikë me pjesëtarët e MFSK-së dhe FSK-së. Në fund, për përfundimin me sukses të trajnimit/seminarit për pjesëmarrësit u ndanë certifikata.

Batalioni i Dytë i BRSH-së realizoi ushtrimin fushor „Ujku 02“

Kompania 2B e Batalionit të Dytë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë, në kuadër të realizimit të planit vjetor të aktiviteteve dhe trajnimeve, për vitin 2018, ka përfunduar trajnimin „Gjenerimi i Forcës“ i cili trajnim u zhvillua nga data 10.09.2018. deri më 06.12.2018. Ky trajnim është përmbyllur me ushtrimin fushor „Ujku 02“. Qëllim i këtij ushtrimi ishte testimi i gatishmërisë dhe personelit të kompanisë 2B, gjatë intervenimeve në operacionet taktike si: pikë kontrolli, okupim i bazës patrulluese, patrullim, sulm në objektivë, ngritja e pikës së vëzhgimit etj.

Pjesëtarët e kompanisë 2B, janë vlerësuar lart nga ekipi vlerësues/kontrollues i BAT-2, për motivin e lartë, disiplinën dhe profesionalizmin e treguar gjatë gjithë kohës së realizimit të ushtrimit fushor.

Në operacionet përfundimtare të ushtrimit fushor „Ujku 02“ që u mbajt në territorin e Istogut, ishin të pranishëm edhe zv. komandanti i BRSH-së, kolonel Hysen Dreshaj, komandant i Batalionit të Dytë, nënkolonel Astrit Haliti, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Zëvendës komandanti i BRSH-së, kolonel Dreshaj, tha: se ushtrimi fushor „Ujku 02“ ishte një ushtrim i nivelit të lartë; me çka tregon, se, BAT-2, ka bërë përgatitje serioze dhe profesionale të cilat i demonstruan pjesëtarët e kompanisë së saj, gjatë këtij ushtrimi. Ai përgëzoi stafin komandues të kompanisë, oficeret, nënoficerët dhe të gjithë pjesëtarët e angazhuar gjatë ushtrimit.

Në përmbylljen e ushtrimit fushor „Ujku 02“ komandanti i BAT-2, nënkolonel Haliti i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe motivimin e treguar gjatë gjithë kohës, për të shtuar; se ky ushtrim dëshmon që ne jemi të gatshëm dhe kemi kapacitete të zhvillojmë operacione që t'iu dalim në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës, në zonën e përgjegjësisë dhe me gjerë.



FSK-ja realizoi një projekt humanitar në Llapashticë të Podujevës

Forca e Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me Komunën e Podujevës kanë realizuar projektin humanitar në fshatin Llapashticë të Epërme, ku kanë bërë nivelimin e oborrit të shkollës fillore "Naum Veqilharxhi" të këtij fshati. Më 7 dhjetor 2018, punimet i përcolli edhe komandanti i BMO-së, gjeneral brigade Naim Haziri dhe komandanti i Batalionit të Xhenios, nënkoloneli Rifat Maloku. Me këtë rast, duke falënderuar FSK-në, për ndihmën që i ka dhënë kësaj shkolle dhe në veçanti nxënësve u shprehën shumë falënderues drejtori i shkollës Musli Muqiqi dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit të Podujevës Agim Blakqori. Ata u ndanë shumë të kënaqur me punën dhe mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së.

Ndërsa, gjenerali Naim Haziri i përgëzoi pjesëtarët e Batalionit të Xhenios, për realizimin e këtij projekti dhe projekteve të tjera humanitare, në ndihmë të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës. Ai tha se ne po mundohemi të jemi gjithmonë afër qytetarëve për realizimin e kërkesave të tyre, duke u bazuar në kapacitete tona, por ndihma e FSK-së, nuk do të mungojë asnjëherë e sidomos kur kemi të bëjmë me fëmijët, të cilët janë e ardhja e këtij vendi.

Me nderime të larta është varrosur kapteri Ali Sinani



Më 14.12.2015, nga familjarë të ushtarakut Ali Sinani, miq, shokë e ushtarakë të Forcës së Sigurisë të Kosovës, i është dhënë lamtumira e fundit nënoficerit të FSK-së, kapterit Ali Sinani.

Në kazermën ,,Adem Jashari" , në mes ditë janë bërë homazhe te arkivoli i Ali Sinanit nga të gjitha njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kolegë, shokë e bashkëluftëtarë të tij.

Më pas kortezhi i përmortshëm ka vazhduar për në fshatin e lindjes ku me nderime ushtarake dhe në praninë e një numri të madh të qytetarëve nga e gjithë Kosova, është varrosur ushtaraku i FSK-së.

Për herë të fundit nga i ndjeri është ndarë komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili në fjalën e tij tha: „Ne, po përpiqemi të mos dorëzohemi para humbjes së madhe, por të ndihemi krenarë që e patëm në mesin tonë. Ndihemi krenarë që bashkërisht ndërtuam themelet e sigurta të ushtrisë së Kosovës për të cilën Aliu punoi pareshtur gjithë jetën".

E nderuar familje, Ushtria e Kosovës, gjithherë do të jetë afër jush, dhe ju gjithmonë do të keni vend të rëndësishëm në organizatën tonë. Në fund të ceremonisë u vendosën kurora të shumta lulesh nga shok, miq, bashkëluftëtarë, kolegë, ushtarakë e shokë nga të gjitha viset shqiptare.

FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 76 • 8 Shkurt 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Kryeministri Haradinaj, ministri Berisha dhe komandanti Rama zbuluan pllakën me mbishkrimin Ministria e Mbrojtjes

Ministri Berisha: Që nga sot jemi Ministri e Mbrojtjes

Prishtinë, 21 Janar 2019- Me një ceremoni të organizuar sot në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sot (21.01.2019) solemnisht zbuluan pllakën me mbishkrimin Ministria e Mbrojtjes.

Në ceremoninë e zbulimit të kësaj pllake, përveç kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ministrit të Mbrojtjes, Rrustem Berisha, komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ishin të pranishëm edhe zv.ministri Agim Çeku, zv.ministri Burim Ramadani, sekretari i përgjegjshëm Shkëlzen Sylaj, gjenerali Gëzim Hazrolli, gjenerali Zymer Halimi, si dhe stafit i lartë i Ministrisë dhe FSK-së.



Me këtë rast, ministri Berisha, para mediave tha se„ sot është një ditë e veçantë për Ministrinë tonë, për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe që nga sot do të ndryshojë emërtimi i Ministrisë në Ministri të Mbrojtjes". Më pas ministri Berisha falënderoi të gjithë ata që kontribuuan që Ministria Forcës së Sigurisë të shndërrohet në Ministri të Mbrojtës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës në Ushtri të Kosovës.

„Zyrtarisht nga sot është dita e parë kur fillon procesi i tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri të Kosovës. Dua t'i falënderoj të gjithë partnerët ndërkombëtarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO-n dhe përfaqësuesit e saj që gjenden sot këtu, në veçanti falënderoj kryeministrin, i cili në vazhdimësi, në të gjitha etapat e ka përkrahur formimin e ushtrisë dhe do vazhdojë ta përkrahë edhe në procesin e tranzicionit", tha ministri Berisha dhe shtoi se i terë procesi do jetë gradual, transparent dhe është paraparë një plan dhjetëvjeçar i arritjes së kapaciteteve të mbrojtës. Në mandatin e ri, siç e kem cekur edhe më herët, Forca e Sigurisë së Kosovës do jetë forcë shumetnike, profesionale e përfaqësuar nga të gjithë qytetarët e Kosovës dhe në interes të të gjithë qytetarëve të saj, por edhe në interes të ndërtimit të paqes në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Pas zbulimit të pllakës, kryeministri Haradinaj ka zhvilluar një takim me ministrin e Mbrojtjes, Rrustem Berisha, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant, Rrahman Rama dhe me përfaqësues të tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët i ka uruar për këtë fazë të re të funksionimit, duke vlerësuar se Forca e Sigurisë së Kosovës do të jetë forcë shumetnike dhe profesionale, e gatshme për të kontribuuar në forcimin e paqes dhe të stabilitetit në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Zyrtarizohen emërimi i Ministrit të Mbrojtjes dhe Komandantit të FSK-së

Prishtinë, 21 Janar 2019- Pas votimit të tri projektligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, nënshkrimit nga Presidenti Hashim Thaçi, si dhe pas publikimit në Gazetën Zyrtare, dje më 21 janar 2019, solemnisht u bë zyrtarizmi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe procesi i tranzicionit të FSK-së në ushtri të Kosovës, si dhe emërimi i Ministrit të Mbrojtjes dhe Komandantit të FSK-së.

Kryeministri i Kosovës me vendimin e nxjerrë më datë 17 janar 2019, ka emëruar Ministër të Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha. Vendim ka hy në fuqi më 20 janar 2019.

Po ashtu edhe Presidenti i Kosovës, z. Hashim Thaçi, ka emëruar zyrtarisht Komandant të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama me mandat 5 vjeçar. Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama u betua para Presidentit të Republikës, z. Hashim Thaçi, se do të vazhdojë t'i shërbejë atdheut dhe mbrojtjes së qytetarëve tanë.





Intervista me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pas formimit të ushtrisë dhe emërimit të tij komandant i saj

Jemi të përkushtuar t'i realizojmë detyrat dhe objektivat që dalin nga misioni i ri



Gazeta FORCA JONË: Urime formimi i ushtrisë dhe emërimi Juaj në detyrën e komandantit?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Ju falemnderit për urimin. Pas votimit të tri projektligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në nga deputetët e Kuvendit të Kosovës (14.12.2018) dhe pas nënshkrimit të tyre nga Presidenti Hashim Thaçi, si dhe pas publikimit në Gazetën Zyrtare, më 21 janar 2019, u bë zyrtarizimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe filloi procesi i tranzicionit të FSK-së në Ushtri të Kosovës. Gjithashtu, presidenti i Kosovës z. Hashim Thaçi më ka emëruar zyrtarisht Komandant të FSK-së- ushtrisë së Kosovës me mision të ri, me mandat pesëvjeçar. Po këtë ditë para presidentit Hashim Thaçi kam dhënë betimin se, do t'i shërbej atdheut dhe mbrojtjes së të gjithë qytetarëve të Kosovës. Tani, para vetes kam përgjegjësi dhe obligime shtesë, për realizimin e procesit të filluar të krijimit të ushtrisë së Kosovës.

Gazeta FORCA JONË: Formimi i ushtrisë është vlerësuar sukses madhor për këtë vit, cili është komenti juaj z. komandant?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Viti 2019 është vit historik për vendin tonë sepse me formimin e ushtrisë është kompletuar arkitektura e sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës. Që nga viti 2014 kur është bërë Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë, ne kemi qenë të përkushtuar duke punuar ngushtë me partnerët tanë strategjikë për krijimin e një plani gjithëpërfshirës të tranzicionit që do të shërbejë si udhërrëfyes për arritjen e kapaciteteve të plota me mandat mbrojtës. Për koincidencë, hyrja në fuqi e tri ligjeve që mundësojnë tranzicionin e FSK-së në mandat mbrojtës, më datë 21.01.2019 shënon edhe 10- vjetorin e themelimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës më 21.01.2009.



Arritja e këtij suksesi vjen si rezultat i punës së përbashkët me të gjitha strukturat shtetërore por edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë. I gjithë ky proces ka qenë transparent dhe gjithëpërfshirës me qëllimin më të mirë që në të ardhmen ta kemi një ushtri moderne, gjithëpërfshirëse, të aftë dhe të gatshme që të mbrojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

Së bashku me parterët tanë, kemi zhvilluar një plan i cili paraqet objektiva të qarta për çdo fazë të tranzicionit përgjatë periudhës 10-vjeçare, dhe në bazë të atij plani ne do t'i zhvillojmë kapacitetet tona mbrojtëse me pajisje dhe infrastrukturë moderne.

Synimi dhe qëllimi ynë strategjik është që të jemi pjesë e strukturave euroatlantike, dhe për ne është shumë e rëndësishme që i gjithë ky proces i tranzicionit të jetë në përputhje me rregullat dhe standardet e NATO-s.

Gazeta FORCA JONË: Pjesëtarët e FSK-së, si në aspekt ekipor ashtu edhe individual, brenda dhe jashtë vendit, kanë treguar arritje të mëdha. Çfarë mund të thoni për këtë?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Unë si komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës ndihem i privilegjuar dhe i nderuar që drejtoj një forcë që në strukturën e saj ka ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të përkushtuar, të motivuar dhe jashtëzakonisht të përgatitur në aspektin profesional. Mbi 90% e pjesëtarëve tanë që kanë vijuar shkollime dhe trajnime jashtë vendit, janë shpallur studentët më të mirë ndërkombëtar. Kjo na ka bërë krenarë jo vetëm ne si Forcë, por edhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Nuk duhet harruar se rezultatet e larta që kanë treguar djemtë dhe vajzat e FSK-së gjatë shkollimit të tyre vjen si rezultat i punës së palodhshme të instruktorëve dhe mentorëve tanë. Ne kemi vendosur standarde të larta të sukseseve si brenda ashtu edhe jashtë vendit, dhe është obligim yni që t'i mbajmë këto standarde, por njëkohësisht të vazhdojmë me angazhime dhe trajnime shtesë për zhvillimin e pjesëtarëve tanë në të gjitha fushat.



Gazeta FORCA JONË: Si komandant i ushtrisë së Kosovës, cilat janë sfidat për ndërtimin e saj?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Çdo proces i tranzicionit ka edhe sfidat e veta. Ka qenë dhe do të mbetet edhe për një kohë sfidë integrimi i komunitetit serb që jeton në Kosovë.

vijon në faqen e tretë

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ne si Forcë kemi pasur sukses të jashtëzakonshëm në integrimin e pjesëtarëve të komunitetit serb në strukturat tona. Pjesëtarët e të gjitha komuniteteve që shërbejnë në FSK trajtohen në mënyrë të barabartë me të gjithë pjesëtarët e tjerë duke i shërbyer vendit me nder dhe dinjitet. Është për keqardhje ndërhyrja e drejtpërdrejtë e Beogradit në frikësimin, shantazhimin dhe pengimin e pjesëtarëve të komunitetit serb, e cila ka lënduar rëndë të gjithë progresin e viteve paraprake të FSK-



së. Si rezultat i këtij procesi sistematik të presionit, ndalimit dhe marrjes në pyetje, pjesëtarët e komunitetit serb pa dëshirën e tyre kanë qenë të detyruar që t'i dorëzojnë kërkesat për demobilizim. Ne si institucion dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të sigurisë në vend kemi bërë përpjekje të vazhdueshme që ky presion nga Beogradi ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb të ndalet, mirëpo edhe përkundër përpjekjeve tona nuk kemi parë progres në këtë drejtim.

Gazeta FORCA JONË: Zoti komandant, cili është mesazhi juaj për pjesëtarët e FSK-së?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama: Se pari, dëshiroj që të gjithë pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës t'ju uroj formimin e Ushtrisë së Kosovës. Mandati i ri për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, nënkupton përkushtim dhe punë shtesë në avancimin e kapaciteteve mbrojtëse, gjithmonë duke punuar ngushtë me partnerët tanë vendorë dhe ndërkombëtarë. Ne do të jemi gjithmonë afër qytetarëve për t'ju krijuar një mjedis të qetë dhe të sigurt.

Në fund, dëshiroj që të gjithë pjesëtarëve t'ju uroj shëndet dhe shumë suksese në ndërtimin e një ushtrie moderne që do të kontribuoj për paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë.

Ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama dekorojnë nënkolonelin Paul Stainthorpe



Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, me një ceremoni zyrtare, të mbajtur sot (11.01.2019) në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, kanë nderuar me mirënjohje dhe dekoratë nënkolonelin Paul Stainthorpe, këshilltar ushtarak i komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramës, pas përfundimit me sukses të detyrës në FSK. Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, me këtë rast e ka falënderuar këshilltarin ushtarak të komandantit të FSK-së, nënkolonelin Paul Stainthorpe, për angazhimin e tij, e në veçanti për përkrahjen që ai ua ka dhënë ushtarëve të FSK-së gjatë ushtrimit „Cambrian Patrol", që ishte një ngjarje vjetore e organizuar dhe e drejtuar nga Brigada 160-të e Këmbësorisë nga Uellsi, me seli në Breçon, dhe ushtrimit "Albanian Lion" të zhvilluar në Shqipëri. Ministri Berisha vlerësoi lart kontributin e nënkolonelit Stainthorpe, me c' rast i dha Mirënjohje për punën e pakursyer gjatë shërbimit të tij në MFSK, ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pasi që e falënderoi këshilltarin e tij, nënkolonelin Stainthorpe, për angazhimin e madh në thellimin e bashkëpunimit dhe kontributin e tij në ngritjen profesionale të FSK-së, e ka dekoruar me Medalje për punë vetëmohuese.

Nga ana e tij, nënkoloneli Paul Stainthorpe falënderoi ministrin Rrustem Berisha dhe komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që i kanë afruar gjatë shërbimit të tij në FSK.



Pjesë nga intervista e zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Burim Ramadani dhënë gazetës, De Volkskrant, (16 janar 2019)
Jarl van der Ploeg

Që nga pavarësia kemi punuar për të transformuar forcën tonë të sigurisë në një ushtri



"Ne jemi një shtet sovran që për vendimet e brendshme nuk konsultohemi me vendet fqinje, posaçërisht jo me Serbinë", thotë Zëvendës Ministri i Mbrojtjes Burim Ramadani. "Që nga pavarësia kemi punuar për të transformuar forcën tonë të sigurisë në një ushtri. Kjo është pjesë normale e procesit të rritjes së një vendi. Çdo shtet sovran në botë ka një ushtri. Pse Kosova mos ta ketë? Se kjo do të ishte një shenjë e agresionit, është propagandë e pastër dhe dezinformim që vjen nga Serbia dhe Putini. Çfarë mund të bëjë një ushtri prej 2,500 trupash kundër një ushtrie prej 50 mijë? Sa na përket ne, gjëja e vetme negative lidhur me këtë vendim, është që është marrë pesë vite me vonesë'.

"Ne kemi vizituar rreth gjysmën e të gjitha vendeve të NATO-s në muajt e fundit dhe kemi shpjeguar se me ushtrinë që po formojë duam të bëjmë diçka të mirë për të gjitha ato shtete që 20 vite më parë ndalën gjenocidin", thotë Ramadani. 'Falë këtij vendimi, ushtarët tanë së shpejti do të jenë në gjendje të qëndrojnë krah për krah me ushtarët e tjerë të NATO-s. Në fakt, shpresojmë që ushtarët tanë do të qëndrojnë krah për krah me ushtarët serbë shumë shpejt. Ne duam të jemi partner, jo kërcënim. '

Intervistë ekskluzive me pilotin e parë ushtarak të Kosovës, nëntoger Afrim Zabeli

Do t'i shërbej me

Afrim Zabeli, më 13 dhjetor 2018, diplomoi për pilotë të helikopterëve në Republikën e Turqisë, gjegjësisht në shkollën ushtarake të Aviacionit Tokësor për Helikopter në Ankara-Isparta. Afrimi është piloti i parë i Kosovës. Ai ka kryer edhe Akademinë Ushtarake Tokësore në Ankara, kursin Bazik për Komando, si dhe trajnime tjera të nivelit të lartë. Për këtë zhvilluam një intervistë për gazetën „Forca Jonë".



Gazeta „Forca Jonë": *Nëntoger Zabeli; Ju jeni piloti i parë i Ushtrisë së Kosovës, me këtë ju jeni bërë pjesë e historisë, çfarë do të thotë kjo për ju?*

Nëntoger Zabeli: Së pari jam shumë me fat që kamë pas mundësinë ta kryej shkollën për Pilot të Helikopterit. Është mundësi që nuk i vjen çdokujt dhe që kërkon përkushtim të madh. Ndihem shumë krenar që jam piloti i parë i Forcës së Sigurisë të Kosovës. Po ashtu diplomimi im një ditë para formimit të Ushtrisë së Kosovës më bën të ndihem shumë mirë. Kam pasur përkushtim të plotë në këtë drejtim, dhe në fund ia arrita qëllimit, dhe kjo arritje padyshim që do të thotë shumë për mua.

Gazeta „Forca Jonë": *Ku i keni përfunduar studimet për aviacion dhe sa kanë zgjatur ato ?*

Nëntoger Zabeli: Studimet për aviacion i kam përfunduar në Republikën e Turqisë, gjegjësisht në shkollën ushtarake të Aviacionit Tokësor për Helikopter. Kam filluar më datën 13.11.2017 në kryeqytetin e Turqisë, në Ankara, dhe i kam përfunduar më datë 13.12.2018, në qytetin Isparta.

Gazeta „Forca Jonë": *Cilat fusha të tjera përveç si Pilot i Helikopterit, keni mbaruar për ushtrinë e planifikuar të Kosovës dhe ku?*

Nëntoger Zabeli: Kam përfunduar Akademinë Ushtarake Tokësore në Ankara, që ka zgjatur pesë vite; një vit kam mësuar gjuhën, ndërsa katër vite kam studiuar në Akademinë e Përgjithshme Ushtarake. Gjatë kësaj periudhe kohore, kemi pasur mundësi të marrim trajnime në fusha të ndryshme. Në vitin e fundit të Akademisë, kam kryer Kursin Bazik për Komando, që ka zgjatur nëntë javë, kurs i fokusuar me aktivitete të shumta fizike dhe teorike. Akademinë Ushtarake e kam përfunduar më 30.08.2018.

Gazeta „Forca Jonë": *Nga kush keni pasur përkrahjen në rrugën tuaj si piloti i parë kosovar?*

Nëntoger Zabeli: Përkrahjen më të madhe e kam pasur nga familja e ngushtë. Pasi që pas përfundimit të Luftës në Kosovë, ne mbetem pa babin dhe vëllain e madh, dhe të gjithë kemi qenë fëmijë, më e rritura prej nesh ka qenë motra 12 vjeçare, kushtet ekonomike nuk i kemi pasur të mira, një ndihmë që kemi pasur nga familja e gjerë, që gjendeshin ne diasporë, dhe nga djali i axhës, që tash është pjesë e Policisë së Kosovës, Avni Zabeli, i cili na ka ndihmuar në shkollimin tonë, dhe asnjëherë nuk e kanë ndërprerë përkrahjen ndaj nesh, por kjo është mëritë e tyre, të jem edhe Piloti i parë i Ushtrisë së Kosovës. E falënderoj Forcën e Sigurisë së Kosovës që tani është Ushtria e Kosovës, që më ka mundësuar që unë ta përfundojë me sukses të lartë Shkollën për Aviacion Tokësor të Helikopterëve.

Gazeta „Forca Jonë": *Cilat ishin reagimet e familjes suaj kur ju keni treguar se synoni të bëheni pilot?*

Nëntoger Zabeli: Si çdo fëmijë, që ka një ëndërr fëmijërore, se çka do të behet në të ardhmen, edhe unë kisha ëndrrën time që së pari të jem pjesë e uniformes në shërbim të atdheut. Dëshira apo ëndrra për të qenë pilot, më ka lindur gjatë kohës së Akademisë Ushtarake, pasi që kemi pasur edhe konferenca për drejtime të ndryshme ushtarake, e një ndër to ka qenë edhe për Pilot të Helikopterit. Dhe nga ai moment kam filluar të interesohem dhe të lexoj më shumë për këtë drejtim. Lajmin për synimin tim që të bëhem pilot e kanë pritur shumë mirë, edhe pse ishte një rrugëtim i vështirë dhe më shumë sfida. Ëndrra më në fund, mu realizua. Tani jam pilot i helikopterit në FSK.

Gazeta „Forca Jonë": *Gjatë luftës së Kosovës ju keni humbur babin dhe vëllain, megjithatë ju nuk jeni dorëzuar dhe keni vazhduar shkollimin tuaj.*

Nëntoger Zabeli: Së pari ndihem krenar që jam fëmijë dhe vëlla i martirëve; që për Lirinë e Kosovës dhanë edhe më të shtrenjtën jetën e tyre. Sa herë kam pasur vështirësi apo pengesë për ndonjë gjë gjithmonë i kam kujtuar babin, vëllain dhe të gjithë



Intervistë ekskluzive me pilotin e parë ushtarak të Kosovës, nëntoger Afrim Zabeli

përkushtim vendit tim



dëshmorët e renë për lirinë e Kosovës, dhe çdo herë e kam ndier vetën më të fuqishëm dhe më krenar, kurrë nuk jam dorëzuar, por kam vazhduar përpara deri këtu ku jam sot.

Fluturimin e parë kam dëshirë ta bëjë në qiellin e vendëlindjes time

Gazeta „Forca Jonë“: *A keni fluturuar me Helikopter mbi qiellin e Kosovës?*

Nëntoger Zabeli: Jo, ende nuk kam fluturuar, por e pres me padurim ditën që të fillojë me fluturime mbi qiellin e Kosovës dhe t'i shërbej vendit tim si pilot. Fluturimin e parë kisha pas dëshirë ta bëj në qiellin e vendlindjes time.

Gazeta „Forca Jonë“: *Çfarë ndjenje keni kur jeni në qiell?*

Nëntoger Zabeli: Është ndjenjë shumë e mirë me plotë emocione të papërshkueshme! Të gjitha bukuritë natyrore apo ato të ndërtuara nga dora e njeriut, që ne i shohim nga toka, t'i shikosh nga qielli, është sikur të jesh në boten e çudirave, pasi që fluturimet që bëhen me Helikopter nuk bëhen në lartësi shumë të madhe, andaj edhe bukuritë natyrore vërehen në detaje, që një njeri që nuk është pilot mundet vetëm me i imagjinua. Ndjenja më e mirë dhe me plot adrenalinë është kur bën lëvizje taktike në një lartësi të vogël nga Toka. Të gjitha këto ndjenja janë të përcjella me një përgjegjësi shumë të madhe, për personelin që gjendet në helikopter, me një fjalë fati i jetës së tyre është në duart e pilotit, prandaj ne jemi edhe të përgatitur që në çdo rast emergjent që mund të ndodh gjatë fluturimit ta kemi çdo herë një vend në mendjen tonë që në rast se ndodh një prishje ta bëjmë uljen emergjente dhe që është shumë e vështirë.

Gazeta „Forca Jonë“: *Cili është mesazhi juaj për rininë kosovare?*

Nëntoger Zabeli: Për rininë e Kosovës, kam një porosi, në çfarëdo vështirësi që hasni mos dorëzoheni, mos e humbni vetëbesimin, gjithmonë të jeni në dijeni se çka po bëni dhe për çfarë po e bëni, dhe çdo synim që keni, mendoni se si do të jetë përfundimi dhe çdo herë do të jeni më të suksesshëm. Rinia e Kosovës le të vazhdojë shkollimin duke synuar që në të ardhmen të jenë pjesëmarrës të vendimeve të rëndësishme për Kosovën, të ngritën profesionalisht në profesione të ndryshme e sigurisht që janë shumë të mirëseardhur që të jenë edhe pjesë e Ushtrisë së Kosovës.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Nëntogeri i FSK-së Petrit Loxha diplomohet për mjete eksplozive

Petrit Loxha, oficer i FSK-së, që nga muaji korrik i vitit të kaluar (2018) e deri më 16 janar 2019, ka ndjekur trajnimin mjaft sfidues që ofron Ushtria Amerikane për mjete eksplozive në shkollën e Marinës, në Bazën Ajrore Eglin në Florida, SHBA. Ai, gjatë shkollimit të tij 24 javor, kaloi nëpër dy faza; Në fazën e parë u aftësua lidhur me çminimin, mjetet dhe metodat, databazën e mjeteve etj., ndërsa në fazën e dytë me mjetet tokësore, mjetet ajrore, mjetet e improvizuara, mjetet kimike dhe biologjike. Përgatitja e oficerit të FSK-së, Petrit Loxha, në këtë fushë do t`i ndihmojë shumë Kompanisë së Deminimit të FSK-së në ngritjen e kapaciteteve të saja në fusha të caktuara dhe në përgatitjen e doktrinave me standardet e NATO-s. Nëntogeri Petrit Loxha gjatë shkollimit/trajnimit në SHBA, u dallua me paraqitje të shkëlqyer si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.

Zëvendësministri Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama pritën komandantin e KFOR-it turk, kolonelin Cen Sinan Barim



Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, sot (21.01.2019) zëvendësministri i Mbrojtjes Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pritën në takim lamtumirës komandantin e deritashëm të kazermës "Sulltan Murat" të KFOR-it turk, në Prizren, kolonelin Cen Sinan Barim, dhe njëherësh i uruan mirëseardhje komandantit të ri të kësaj kazerme, kolonelit Numan Baá[1]£.Zv. ministri Ramadani dhe gjeneral Rama, vlerësuan lart kontributin e komandantit në largim kolonelit Barim, gjatë shërbimit të tij në Kosovë dhe bashkëpunimin korrekt me ushtrinë dhe shtetin turk. Zëvendësministri Ramadani, u shpreh: „Besoj se Turqia si shtet mik dhe aleat i Kosovës, si një anëtar i NATO-s, do të luaj një rol të rëndësishëm në dhënien e ndihmës për integrimin edhe të Kosovës në NATO. Tani me krijimin e ushtrisë, Kosova po e mbyll një kapitull shumë të rëndësishëm për sa i përket çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes", tha, në fjalën e tij, zëvendësministri Ramdani. Ndërsa, komandanti i kazermës „Sulltan Murat", Cen Barim, falënderoi zëvendësministrin Ramadani dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramën, stafin e Ministrisë dhe FSK-së, për bashkëpunimin e shkëlqyer, duke u shprehur i kënaqur me të arriturat e FSK-së dhe të Kosovës. Zëvendësministri Ramadani, në emër të ministrit të Mbrojtës z. Rrustem Berisha, i dha mirënjohje për shërbim të lartë kolonelit Cen Sinan Barim. Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, e dekoroi me mirënjohje dhe pllakat kolonelin Cen Barim, për kontributin e veçantë gjatë shërbimit të tij dyvjeçarë në Kosovë.

Diplomatë dhe oficerë-kadetë të Ambasadës së Norvegjisë në FSK



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), më 19 janar 2019, për vizitë zyrtare ishin diplomatë dhe oficerë-kadetët të Ambasadës së Norvegjisë në Republikën e Kosovës në Prishtinë dhe të Ambasadës së Norvegjisë në Beograd. Delegacioni i diplomatëve norvegjezë, në ambientet e Ministrisë së FSK-së, u prit nga koloneli Agron Bajrami, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, koloneli Haki Hoti, drejtor i Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim të FSK-së, majori Vegim Kerlani, komandant i Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së dhe kapiteni Jaser Mulla, oficer i kabinetit të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, koloneli Agron Bajrami, pasi që i përshëndeti mysafirët, i njoftoi edhe me aktivitetet e përgjithshme të MFSK/FSK-së.
Ndërsa, koloneli Haki Hoti, përmes një prezantimi e njoftoi delegacionin norvegjez me zhvillimet e përgjithshme të FSK-së, misionin, strukturën, kapacitet, operacionet, trajnimet, planifikimin, rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë dhe tranzicionin e MFSK-së në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK-së në ushtri. Ai, gjithashtu i njoftoi diplomatët norvegjezë edhe me sukseset e arritura të FSK-së, ngritjen profesionale, trajnimin, shkollimin, si dhe bashkëpunimin dhe partneritetin e ndërtuar me vendet anëtare të NATO-s, SHBA-të, Gardën Kombëtare të Ajovës dhe vendet tjera rajonale dhe ndërkombëtare. Koloneli Agron Bajrami i njoftoi mysafirët për Planin e integritetit dhe kontributin e madh që ka dhënë Qeveria e Norvegjisë në këtë drejtim, si dhe foli edhe për sukseset e pjesëtarëve të FSK-së në shkollimet jashtë vendit, si në akademi të ndryshme ushtarake dhe trajnime dhe ushtrime të përgjithshme. Diplomatët dhe oficerët-kadetë nga Norvegjia me interesim përcollën ligjëratën e kolonel Hotit, si dhe njoftimet e përgjithshme nga ana e kolonelit Agron Bajrami. Ata në fund parashtruan shumë pyetje lidhur me zhvillimet dhe proceset e ardhshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Diplomatët norvegjezë më pastaj vizituan edhe Qendrën për Studime Universitare të FSK-së.

Dhurimi vullnetar i gjakut, 2019

Aktiviteti i parë humanitar i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Kosovës



Aksioni për dhurimin vullnetar të gjakut me moton „Dhuro gjak, shpëto jetë'' për nevoja të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës(QKTGJK), është aktiviteti i parë humanitar pas zyrtarizimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë. Pas Ministrisë së Mbrojtjes (24.01.2019) aktiviteti po zhvillohet edhe në Kazermën e Forcave Tokësore (KFT) „Adem Jashari në Prishtinë. Me këtë rast, drejtori i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë e Mbrojtjes, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, duke parë nga afër mbarëvajtjen e aktivitetit, përgëzoi ushtarakët dhe shërbyesit civilë të FSK-së për gatishmërinë dhe motivimin e tyre për të dhuruar gjak, në të mirë të shëndetit të pacientëve të institucioneve shëndetësore të vendit tonë. Vetëm gjatë ditës së djeshme në Ministrinë e Mbrojtjes, aksionit i janë përgjigjur mbi 50 dhurues vullnetarë, ndërsa sot mbi 70 dhurues nga KFT-ja dhe njësive pranshtabore të saj.

Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në të gjitha kazermat e Forcës së Sigurisë të Kosovës do të vazhdojë deri më 4 shkurt 2019. Ky është aksioni i parë humanitar për dhurimin e gjakut për këtë vit, dhe sipas planifikimit aksioni i dytë pritet të zhvillohet në muajt korrik dhe gusht. Theksojmë se ushtarakët e FSK-së, përveç në aksione çdo herë kanë shprehur gatishmërinë që t'iu përgjigjen kërkesave edhe në periudha të tjera të vitit.

Në Kazermën „Adem Jashari“

U mbajt seminari ndërkombëtar „Backbone“

Në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë, më 21 janar 2019, u mbajt ceremonia e certifikimit e nënoficerëve, të cilët përfunduan seminarin ndërkombëtar „Backbone“. Në këtë seminar, të organizuar me qëllim të zhvillimit të nënoficerëve dhe përgatitjes së tyre për të punuar në ambiente ndërkombëtare, morën pjesë mbi 60 pjesëtarë, 26 prej të cilëve ishin pjesëtarë të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), kurse të tjerët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Sllovenia, Turqia dhe Polonia. Për t'i nderuar pjesëmarrësit dhe instruktorët amerikanë të cilët mundësuan realizimin e këtij seminari, të pranishëm në ceremoni ishin edhe përfaqësuesit e FSK-së, Ambasadës Amerikane, KFOR-it dhe US Balkan National Support Element. Para



të pranishmeve foli rreshteri i parë i komandantit të FSK-së, Genc Metaj, i cili njëherazi në bashkëpunim më përfaqësuesin e EUCOM-it, Cris Addigton, organizuan këtë seminar. Rreshteri Metaj pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit në emër të komandantit të FSK--së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, u shpreh: „Është kënaqësi e imja dhe e FSK--së që patëm mundësi që t'i shkëmbejmë përvojat tona dhe t'i ndajmë njohuritë së bashku përgjatë këtyre ditëve. I përgëzoj pjesëmarrësit për angazhimin, dhe jam i sigurt, që të gjitha këto mësime që u ligjëruan gjatë këtyre ditëve, do t'ju shërbejnë në të ardhmen në jetën tuaj të përditshme. Ndërsa në emër të instruktorëve amerikanë, foli Cris Addigton, i cili shprehet mjaft falënderues për bashkëpunimin me FSK-në. Ai nder tjera shtoi: „ Ndërtimi i marrëdhënieve të mira ndërkombëtare ka një rëndësi të veçantë për të ecur përpara, pasi që, ne asnjëherë nuk do luftojmë të vetëm, dhe ky bashkëpunim do na ndihmojë të gjithëve në të ardhmen". Gjatë këtij seminari, instruktorët shtjelluan tema nga më të ndryshmet të cilat do u ndihmojnë nënoficerëve gjatë karrierës së tyre ushtarake, si: Roli i nënoficerit në ushtri, marrëdhënia e oficerit me nënoficerin, ndërtimi i marrëdhënieve pozitive, mësimdhënia, identiteti i shërbimit e luftimi së bashku, rolet ndërkombëtare etj. Në fund të ceremonisë për pjesëmarrësit e trajnimit u ndanë certifikata.


Kadetët e Qendrës për Studime Universitare

Realizuan trajnimin për Kërkim-Shpëtim në Male

Sipas plan-programit të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë të Kosovës, nga data 9 deri më 18 janar, kadetët e QSU-së kanë realizuar trajnimi semestral për vitin 2019 në hapësirat trajnuese të kazermës „Skënderbeu“ në Ferizaj. Në këtë trajnim ishin përfshirë kadetët e tri gjeneratave, të cilët varësisht nga niveli i tyre i zbatuan në praktikë të gjitha ato njohuri që i kishin mësuar përmes ligjëratave dhe laboratorëve gjatë semestrit të kaluar të vitit akademik 2017/2018. Trajnimi është planifikuar dhe realizuar nga instruktorët e QSU-së dhe kishte karakter vlerësues. Ndërsa, nga data 8 deri më 18 janar, kadetët e vitit të katërt kanë përfunduar trajnimin „Kursi trajnues për kërkim-shpëtim malor“ të realizuar nga Qendra Trajnuese e Kërkim Shpëtimit e Regjimentit të Mbrojtjes Civile. Vlen të ceket se reshjet e shumta të dëborës dhe temperaturat e ulëta ishin sfidë për stafin trajnues dhe kadetët, veçanërisht në pjesën e trajnimit gjatë netëve me mot të ftohtë, por assesi



nuk ndikuan në zbatimin e plan-programit dhe aktiviteteve të planifikuara. Gjatë vizitës që u bëri të dy lokacioneve që zhvilloheshin trajnimet, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, vlerësoi lart angazhimin dhe profesionalizmin e instruktorëve si dhe motivin dhe gatishmërinë e kadetëve, përkundër motit jo të mirë dhe sfidave të tjera.



Prishtinë, 21 Janar 2019

Momente nga zbulimi i Pllakës me mbishkrimin - Ministria e Mbrojtjes, nga kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama











FORCA JONË

••• Viti VIII • Nr. 77 • 8 Mars 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës •••

Ministri Berisha dhe komandant Rama pritën delegacionin e lartë të NATO-s



Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën sot në Ministrinë e Mbrojtjes një delegacion nga Aleanca Veri-Atlantike(NATO), në krye me Jonathan Parish, zëvendës asistent i Sekretarit Gjeneral të NATO-s për Operacione si dhe drejtorin e Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s, z. Michel Soula. Ministri Berisha dhe gjeneral Rama zhvilluan takime të ndara me delegacionin e NATO-s, në të cilat u bisedua kryesisht për situatën e sigurisë në Kosovë e rajon, zhvillimet rreth tranzicionit të FSK-së, marrëdhëniet Kosovë – NATO dhe perspektivën e këtyre marrëdhënieve në të ardhmen.

Krerët e FSK-së e njoftuan drejtorin e Operacioneve të NATO-s mbi zhvillimin e FSK-së, planet për të ardhmen, rikonfirmuan vullnetin e Kosovës për avancimin e marrëdhënieve me KFOR-in, NATO-n, si dhe konfirmuan vendosmërinë e Kosovës për anëtarësim në NATO.

Vizitë e senatorëve të SHBA-ve në FSK



Më 17.02.2019, në Komandën e Forcave Tokësore të FSK-së, nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama u prit një delegacion i senatorëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kryesuar nga senatori James M. Inhofe - Kryesues i Komitetit të Senatit për Shërbimet e Armatosura, i cili shoqërohej edhe nga senatorët: Michel B. Enzi; John N. Boozman; Marion Round dhe përfaqësuesit Trent Kelly dhe Gregory Gianforte.

Në takim, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i njoftoi senatorët për aktivitetet e zhvilluara në kuadër të partneritetin tonë me SHBA-të, rëndësinë që ka për ne ky partneritet dhe në veçanti për Programin e Partneritetit Shtetëror me IOWA-në, bashkëpunimi me Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NALT) që është i atashuar në Ministri dhe Forcë si dhe bashkëpunimin e mirë me KFOR-in. Po ashtu gjeneral Rama i njoftoi mysafirët e lartë nga SHBA-të edhe me detyrat dhe planet që e presin FSK-në, me mision të ri-mision ushtarak, në ngritjen e strukturës dhe kapaciteteve operacionale, duke bashkëpunuar ngushtë me SHBA-të, me partnerët tjerë strategjikë, NATO-n dhe vendet aleate.

Kryesuesi i delegacionit të senatorëve nga SHBA-të, senatori James Inhofe ndër të tjera u shpreh se: "Jam i nderuar që udhëheq delegacionin nga Kongresi amerikan në Kosovë. Kosova është një partner i rëndësishëm për Shtetet e Bashkuara dhe për NATO-n, pasi që punojmë së bashku në ndalimin e rritjes së agresionit rus në rajon". Në takim ishin të pranishëm edhe gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe kolonel Jeton Dreshaj.

Medalje për oficerët e FSK-së që kryen Akademinë Ushtarake Sandhurst

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, para oficerëve të FSK-së të cilët kanë kryer Akademinë Ushtarake Sandhurst në Mbretëri të Bashkuar, u mbajt ligjërata "Qasja në lidership" nga kolonel Roddy Winser, ligjërues i Akademisë Mbretërore Ushtarake Sandhurst. Pas përfundimit të ligjëratës, me një ceremoni rasti u ndanë medalje për të gjithë oficerët e FSK-së, të cilët kanë kryer Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst në Mbretërinë e Bashkuar.

Në ceremoni ishin të pranishëm, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovës, Ruairi O'Connell, koloneli Roddy Wisner, atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar nënkoloneli Andy Layton, gjeneral majori Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneral brigade Irfete Spahiu, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Xhevahir Geci, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, gjeneral brigade Naim Haziri, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Vazhdon në faqe 5,



Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha takohet me zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë

Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, me rastin e shënimit të 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ka marrë pjesë në organizimin e ashtuquajtur "Java e Kosovës në Kroaci". Ndër aktivitetet e organizuara me këtë rast, veç tjerash, ministri Berisha është takuar me zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtës të Kroacisë, me gjeneralë të ushtrisë kroate, si dhe me zyrtarë të tjerë të shtetit mik kroat, me të cilët ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit të mëtejmë ndërmjet Ministrisë së Mbrojtës dhe Ushtrisë Kroate me Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës dhe FSK-në.

Gjatë qëndrimit në Kroaci, ministri Berisha, ka zhvilluar një takim të veçantë edhe me ambasadorin e Kanadasë në Republikën e Kroacisë, z. Daniel Maksymiuk, me të cilin ka biseduar rreth zhvillimeve aktuale, bashkëpunimit të mëtejmë ndërmjet dy vendeve mike, dhe njëherësh ministri Berisha e ka njoftuar ambasadorin Maksymiuk me ecurinë e zhvillimeve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës.



Kosova dhe Franca avancojnë partneritetin për siguri dhe integrimet euro-atlantike



Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Burim Ramadani pritet nga znj. Geneviève Darrieusecq, sekretare e Shtetit pranë Ministrisë së Armatave, në kryeqytetin e Francës në Paris. Zëvendësministri Ramadani dhe sekretarja e Shtetit, znj. Darrieusecq, gjatë takimit kanë ritheksuar vullnetin dhe gatishmërinë për thellimin dhe avancimin e marrëdhënieve bilaterale midis Kosovës dhe Francës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritashëm, ishte konstatim i përbashkët për detajimin e raporteve bilaterale në mënyrë që FSK-ja të avancojë edhe më tutje në profesionalizimin e saj, veçanërisht në fushën e edukimit, sipas standardeve më të larta demokratike.

"Kosova e sheh Francën si partner të rëndësishëm në forcimin e institucioneve tona, si dhe në rrugën tonë për anëtarësim në NATO. Kosova ka qëllim shtetëror integrimet euro-atlantike dhe ne synojmë të jemi vendi i 31-të anëtar i NATO-s", ka theksuar zëvendësministri Ramadani. Ai falënderoi Francën dhe Ministrinë e Armatave për mbështetjen që i kanë dhënë procesit të tranzicionit të FSK-së, si proces gradual dhe transparent. Zëvendësministri Ramadani, gjatë takimit, theksoi përkushtimin e Kosovës për të qenë kontribuuese për sigurinë rajonale dhe globale, duke vlerësuar lart aleancat dhe partneritetin me shtetet e NATO-s.

Sekretarja e Shtetit në Ministrinë franceze të Armatave, znj.Darrieusecq, shprehu gatishmërinë e Francës për të punuar ngushtë me Kosovën me qëllim të ndërtimit të paqes, besimit, stabilitetit dhe perspektivës perëndimore për tërë Ballkanin. Zëvendësministri Ramadani gjatë qëndrimit në Francë do të zhvillojë takime edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ndërsa, paraprakisht së bashku me ambasadorin e Kosovës në Francë, z. Qëndrim Gashi, ka marrë pjesë në homazhet për të rënët për lirai, në Harkun e Triumfit. Po ashtu, do të merr pjesë edhe në aktivitetet që zhvillon Ambasada e Kosovës në Paris, për nder të 11-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Takim i përbashkët i zv.ministrave të Mbrojtjes së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut



Në Tiranë, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Burim Ramadani u prit në takim zyrtar nga zëvendësministri i Mbrojtjes së Shqipërisë z. Petro Koçi. Në takim ishte edhe zëvendësministri i Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut z. Bekim Maksuti.

Takimi në Ministrinë shqiptare të Mbrojtjes kishte karakter diskutimi të përbashkët lidhur me përvojat në rajon në rrugën e integrimeve në NATO dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm midis shteteve në çështjet e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes. Zëvendësministri Ramadani vlerësoi lart takimin konsultues të këtij formati, duke theksuar dëshirën për zgjerimin e përfaqësimit edhe të shteteve tjera në rajon. „Rajoni ynë dhe shtetet tona kanë nevojë të vazhdueshme për shkëmbimin e përvojave në proceset integruese, si dhe thellimin e bashkëpunimit për të promovuar vlerat perëndimore të rajonit", tha zv. ministri Ramadani. Ai theksoi se Kosova është e përkushtuar në rrugën drejt NATO-s, dhe se anëtarësimi i shteteve të Ballkanit në NATO është alternativa më e mirë për zhvillimin e rajonit të sigurt dhe me prosperitet.

Ministri Berisha uron ministren Shekerinska për pranimin e Maqedonisë së Veriut në NATO



Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha ka uruar ministren e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë së Veriut, zonjën Radmila Shekerisnka me rastin e nënshkrimit të protokollit në Bruksel, akt ky që i hapi rrugë fqinjit tonë për anëtarësim në Aleancën Veri-Atlantike. Me këtë rast, ministri Berisha duke uruar ministren Shekerinska dhe nëpërmjet saj edhe të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut u shpreh: „ Uroj ministren e Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, znj. Radmila Shekerinska dhe popullin e Maqedonisë së Veriut për këtë ditë historike, pas një rrugëtimi të gjatë dhe të vështirë".

Aktin e pranimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, ministri Berisha e cilësoi si të një rëndësie të veçantë: „Nënshkrimi i protokollit i pranimit të fqinjit tonë, Maqedonisë së Veriut në NATO, është një lajm i rëndësishëm dhe një hap i madh për stabilitetin dhe sigurinë në rajon".

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Ministri Rrustem Berisha priti në takim ministrin Rasim Demiri



Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, ka pritur në takim ministrin e Zhvillimit Rajonal z. Rasim Demiri. Ministri Berisha e njoftoi ministrin Demiri për zhvillimet në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministri Berisha e falënderoi ministrin Demiri për përkrahjen e vazhdueshme të komunitetit boshnjak të Kosovës për Ministrinë dhe FSK-në. Ministri Berisha në fjalën e tij ndër të tjera tha: "Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, ka dëshmuar në vazhdimësi se është shtëpia e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Ne do të vazhdojmë të ofrojmë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim etnie apo gjuhe". Ndërkaq, ministri Demiri u shpreh: "Ju falënderoj juve personalisht si ministër dhe Ministrinë që e udhëhiqni, për përkrahjen që keni dhënë për komunitetin boshnjak. Ne jemi shumë të kënaqur me përkushtimin tuaj për të përkrahur komunitetet, andaj edhe përkrahja për ju, nga ana jonë, nuk do të mungojë. Komuniteti boshnjak i Kosovës, do të jetë pjesë e pandashme për zhvillimin e shtetit të pavarur të Kosovës".

Zv. ministri Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama pritën ish-komandantin e FSK-së Sylejman Selimin



Ish-komandanti i UÇK-së, TMK-së dhe FSK-së, gjenerallejtënant Sylejman Selimi, vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, ku është pritur nga zëvendësministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Në pritje morën pjesë edhe sekretari i përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj, gjeneral majori Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, Faruk Geci, drejtor i Politikave dhe Planeve etj. Me këtë rast, zv. ministri Ramadani, i ka uruar lirimin nga burgu Sylejman Selimit, duke i dëshiruar shëndet dhe qëndrim të këndshëm në mesin e familjes, shokëve dhe miqve.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e njoftoi zotin Selimi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe tranzicionin e saj në Ushtri të Kosovës dhe të MFSK-së në Ministri të Mbrojtjes. Nga ana e tij, ish-komandanti i FSK-së Sylejman Selimi, e përgëzoi stafin e saj për formimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Kosovës.

Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi mori pjesë në dy ushtrime fushore në Turqi

Me ftesë të komandantit të Forcave Tokësore të ushtrisë turke, nga data 19-22 shkurt 2019, për vizitë në Turqi, ishte komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi.

Qëllimi i vizitës ishte pjesëmarrja në DV-day të dy ushtrive fushore që u realizuan në Turqi, gjatë muajit shkurt. Më datë 20 shkurt, gjeneral Cikaqi mori pjesë në DV- day të ushtrimit vendkomandë „Cooperative Resolve 2019", ushtrim që u realizua në Qendrën e Trajnimit dhe Edukimit në Ankara. Gjatë vizitës në këtë qendër, gjenerali u prit nga komandanti i Forcave Tokësore të ushtrisë turke gjenerali Umit Dundar, i cili shprehu gatishmërinë e ushtrisë turke për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Forcave Tokësore të dy ushtrive. Megjithëse Forca e Sigurisë së Kosovës nuk ishte e angazhuar në këtë ushtrim, me anë të kësaj vizite, gjeneral Cikaqi pati rastin që nga afër t'i shihte angazhimet e shteteve



të tjera pjesëmarrëse dhe qëllimin e trajnimit. Andaj, angazhimi i pjesëtarëve të FSK-së, në kuadër të këtij ushtrimi në vitet e ardhshme do t'i kontribuonte përmirësimit të trajnimit, bashkëpunimit dhe ndërveprimit të FSK-së, në raport me shtetet e rajonit.

Në po të njëjtën datë, gjeneral Cikaqi u prit në darkë zyrtare nga gjenerali Dundar, ku ishin të pranishëm edhe gjeneralë të tjerë dhe shefa të ushtrive të rajonit dhe më gjerë. Më datë 21 shkurt 2019 gjeneral Cikaqi mori pjesë në realizimin e demonstrimeve të ushtrimit "Dimri", ku në mesin e shumë shteteve pjesëmarrëse ishin edhe shtatë pjesëtarë të FSK-së. Realizimi i suksesshëm i ushtrimit "Dimri" demonstroi përgatitje shumë të mëdha dhe të koordinuara deri në detaje në realizimin e skenarëve të operacioneve ofensivë.

Qëllimi i këtij ushtrimi ishte testimi i kapaciteteve luftuese të njësive dhe përmirësimi i sinkronizimit të zjarrit dhe manovrimit në kushte dimri. Në këtë ushtrim morën pjesë rreth 1750 pjesëtarë nga 15 shtete të rajonit, duke përfshirë Kosovën, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Gjeorgjinë, Azerbajxhanin, Bangladeshin, Bosnjën dhe Hercegovinën, Bullgarinë e të tjera. Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës përfituan nga përvoja e madhe e ushtrisë turke në organizimin e ushtrimeve të tilla me karakter ndërkombëtar, dhe këto njohuri do të ndihmojnë në përmirësimin e qasjes tonë në organizimin e ushtrimeve fushore në FSK. Po ashtu më 21 shkurt 2019, me ftesë të Ambasadës së Kosovës në Turqi, gjeneral Cikaqi mori pjesë në pritjen e organizuar me rastin e shënimit të 11- vjetorit të Pavarësisë, ku pjesëmarrës ishin diplomatë nga shumë vende të rajonit. Gjatë pritjes gjeneral Cikaqi takoi të gjithë kadetët dhe ushtarakët e FSK-së, që po realizojnë studimet në Turqi, të cilët i uroi për rezultatet e arritura dhe u kërkoi që të vazhdojnë të jenë të disiplinuar, të angazhuar dhe të përfaqësojnë Kosovën me dinjitet në akademitë ku po studiojnë. Gjeneral Cikaqi, gjatë vizitave u shoqërua nga atasheu ushtarak i FSK-së në Turqi, koloneli Bekim Osmani.

Ministri Rrustem Berisha priti deputetët e Grupit Parlamentar 6 Plus

Ministri i Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha, ka pritur në takime të ndara deputetët e Kuvendit të Kosovës, Albert Kinolli dhe Danush Ademi dhe deputetet Myfera Shinik dhe Fikrim Damka nga Grupi Parlamentar 6 Plus. Ministri Berisha falënderoi deputetët për përkrahjen e tyre të jashtëzakonshme në të gjitha proceset që ka kaluar Kosova e veçanërisht për përkrahjen e pakursyer për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

"Deklaratat, aktivitetet tuaja dhe angazhimi juaj në Kuvend, na kanë bërë të ndihemi jashtëzakonisht mirë, sidomos, pasi kjo përkrahje ka ardhur nga ju, si përfaqësues të komuniteteve pakicë të Kosovës. Kjo tregon besimin që ka Ushtria jonë tek qytetarët e vendit, tek të gjitha komunitetet"- tha ministri i Mbrojtjes, z. Berisha.

Ministri Berisha, më tej tha, se "Tani kemi detyrë të punojmë sa më shumë për ngritjen e kapaciteteve të ushtrisë sipas dinamikës së paraparë me planin e tranzicionit". Deputetët e komunitetit ashkali dhe romë, z. Kinolli dhe Ademi, pasi uruan ministrin Berisha për Ushtrinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, u zotuan se do të vazhdojnë ta mbështesin çdo nismë në të mirë të të gjithë qytetarëve dhe në të mirë të Kosovës.

Gjithashtu edhe deputetët e komunitetit turk, Shinik dhe Damka, pasi uruan ministrin Berisha për Ushtrinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, u zotuan se do të vazhdojnë të mbështesin çdo nismë në të mirë të qytetarëve të Kosovës. "Ne si komunitet, jemi shumë të gëzuar që tani kemi ushtrinë tonë, do të vazhdojmë të mbështesim gjithçka që vjen në Kuvend, dhe me mundësitë tona, e që është për të mirën e vendit tonë. Djemtë dhe vajzat e komunitetit tonë janë të gatshëm dhe shumë të interesuar t'i bashkëngjitën ushtrisë", theksuan ata.

FOTOLAJM

Zv.ministri Ramadani dhe ambasadori Gashi homazhe te varri i ushtarit të panjohur në Paris

18.02.2019



FSK-ja parakaloi në përvjetorin e 11-të

Në përvjetorin e 11-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në sheshin „Skënderbeu“ parakaluan kuadratet e Ushtrisë së Kosovës para udhëheqësve shtetërorë dhe mijëra qytetarëve. Ceremonia solemne e manifestimit filloi me intonimin e himnit të Kosovës nga Orkestra frymore e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Në manifestimin qendror që u mbajt me këtë rast ishin të pranishëm udhëheqësit shtetërorë të Kosovës; presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, kryeministri i Republikës Shqipërisë Edi Rama, ambasadori i SHBA-ve, Fhilip Kosnnet, vëllai i komandanti legjendar Adem Jashari, Rifat Jashari, ministra dhe mysafirë të shumtë, ambasadorë, diplomatë, përfaqësues të KFOR-it, si dhe mijëra qytetarë të Kosovës dhe trojeve etnike. Po ashtu ishin të pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, zyrtarë të lartë të ministrisë, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së.

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, gjatë fjalimit të tij, në përvjetorin e 11-të të Pavarësisë, pos tjerash tha se FSK-ja është krenaria e Kosovës.

„Para nesh kemi një ushtri profesionale, e cila është në shërbim dhe mbrojtje të shtetit më të ri në Evropë, e gatshme për të kontribuar për paqe në rajon dhe botë. Vendimi për themelimin e ushtrisë ishte i drejtë, legjitim dhe mesazh historik“ tha pos tjerash presidenti Thaçi. Pas fjalës së presidentit, komandanti i parakalimit, gjeneral brigade Enver Cikaqi, raportoi para presidentit Hashim Thaçi, për gatishmërinë e kuadrateve të Forcës së Sigurisë së Kosovës për parakalim. Kuadratet e FSK-së parakaluan duke filluar nga Togu Ceremonial, Batalioni i Parë i BRSH-së, Batalioni i Dytë i BRSH-së dhe Batalioni i Tretë i BRSH-së, Brigada e Mbështetjes Operacionale, Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendra për Studime Universitare dhe Orkestra Frymore e FSK-së. Kuadratet e FSK-së, gjatë parakalimit u shoqëruan me brohoritje dhe duartrokitje nga qytetarët e pranishëm në sheshin Skënderbeu.







Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i FSK-së homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz

Me rastin 11- vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në kuadër të delegacionit shtetëror, bënë homazhe te varri i komandanti legjendar Adem Jashari, në Kompleksin Memorial në Prekaz.

Po ashtu, ministri Berisha dhe komandant Rama, bënë nderime edhe tek shtatorja e ish-presidentit Ibrahim Rugova. Po ashtu, me rastin e ditës së Shpalljes së Pavarësisë, delegacion i lartë i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, bënë homazhe dhe vendosen lule të freskëta te varri i komandantit legjendar Adem Jashari në Kompleksin Memorial në Prekaz.



të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës



Medalje për oficerët e FSK-së që kryen Akademinë Ushtarake Sandhurst

Vijon nga faqja parë,

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pasi përshëndeti të pranishmit, i përgëzoi oficerët e FSK-së për arritjet e tyre gjatë studimeve në Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst. Ai pos tjerash, tha: „Padyshim që synojmë të rrisim bashkëpunimin me Mbretërinë e Bashkuar, në mënyrë që t'u përgjigjemi nevojave tona në kuadër të zhvillimit të forcës, por edhe të shprehim gatishmërinë që të ofrojmë kapacitetet tona, duke kontribuar kështu në ruajtjen e paqes kudo në botë. Si rezultat i bashkëpunimit të ndërsjellë, FSK-ja për herë të parë do të dërgojë një oficer të saj, në detyrën e instruktorit të kësaj akademie të respektuar. Andaj, shfrytëzoj këtë rast që të falënderoj Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, për mundësinë që edhe ne të kontribuojmë në zhvillimin e liderëve të rijnë".

Ndërsa ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovës, Ruairi O'Connell, ndër të tjera tha: "Kosova është vendi më i ri në pertneritet me vendin tonë, prandaj ndikimi i secilit oficer çdo ditë është i matshëm. Është krenari për vendin tim sepse që nga fillimi kemi qenë me ju dhe po vazhdojmë ta mbështesim Forcën tuaj, duke bartur përvojat tona te ju. Kosova duhet t'i përdorë këto përvoja, varësisht nga nevojat që kanë oficerët tuaj t'i përdorin përvojat e fituara, në mënyrë që të japin kontributin e vet dhe të shkruajnë kapitullin e tyre në historinë e Kosovës". Në fund oficerëve të FSK-së, të cilët kanë kryer Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, për suksesin e treguar ju ndanë medalje nga gjeneral Rama, ambasadori O'Connell, atasheu ushtarak nënkolonel Layton dhe koloneli Winser.



Zëvendëskomandanti i KFOR-it gjenerali Reinhard Ruckenstuhl vizitoi Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Istog

Në kazermën „Ushtarët e NATO-s“ të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, qëndroi për vizitë pune, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Reinhard Ruckenstuhl, i cili shoqërohej nga komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi. Ata u pritën nga komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj.



Me këtë rast, zv. komandanti i KFOR-it, gjeneral Ruckenstuhl u njoftua me përbërjen dhe nivelin operacional të BRSH-së, aktivitetet e zhvilluara, bashkëpunimin me KFOR-in dhe NALT-in, ndihmën e ofruar në trajnime dhe ushtrime të përbashkëta dhe vazhdimin e bashkëpunimit të afërt ndërmjet KFOR-it , FSK-së dhe BRSH-së.

Gjithashtu u bisedua edhe për stërvitjet dhe operacionet e përbashkëta, tani kur veç ka filluar edhe faza e planifikimit të ushtrimit ndërinstitucional „Silver Sabre 2019” që organizohet nga KFOR-i, ku marrin pjesë të gjitha institucionet e Sigurisë që veprojnë në Kosovë. Pas takimit, zv. komandanti i KFOR-it, gjenerali Ruckenstuhl dhe gjeneral Cikaqi vizituan ambientet e kazermës „Ushtarët e NATO-s“ dhe u informuan për aktivitetet e kësaj brigade, të cilat janë rutinë dhe zhvillohen sipas planifikimit. Gjenerali Reinhard Ruckenstuhl u shpreh shumë i impresionuar me nivelin e profesionalizmit dhe aplikimit të procedurave bashkëkohore të realizimit të detyrave të BRSH-së.

Kolonel Isufi diplomon në Institutin Shumëkombësh të Udhëheqjes Strategjike në Stamboll



Koloneli Sefer Isufi ka diplomuar në Universitetin e Mbrojtjes në Stamboll, gjegjësisht në Institutin Shumëkombësh të Udhëheqjes Strategjike të Forcave të Përbashkëta, në degën e Komandimit dhe Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura në Operacione të Përbashkëta. Në ceremoninë e diplomimit morën pjesë përfaqësuesit e lartë institucionalë dhe ushtarakë si dhe përfaqësues institucionalë dhe ushtarakë nga vendet pjesëmarrëse në institutin përkatës.

Në ceremoni ishte edhe atasheu i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës koloneli Bekim Osmani, cili u prit nga Rektori i Universitetit të Mbrojtjes, prof. dr. Erhan Afyoncu. Kolonel Osmani në emër të ministrit të Mbrojtjes dhe komandantit të FSK-së, përcolli falënderimet e tyre për shkollimin e oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së, në të gjitha nivelet që ofron Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare i Turqisë. Kolonel Seferi tregon se plan-programi studimor, ka përfshirë në mënyrë kronologjike modulet rreth sigurisë globale, rajonale dhe nacionale, ndërlidhjen e tyre me strategjitë nacionale të mbrojtjes dhe ushtarake, si dhe procesin e implementimit të tyre në operacione të mundshme të të gjitha komponentëve të forcave (joint) nga niveli i komandimit dhe drejtimit strategjik ushtarak.

Pasi kreu shkollimin për udhëheqje shtabore dhe komanduese në nivelin taktik dhe operacional ushtarak dhe pasi mbrojti temën e masterit në artin e menaxhimit strategjik të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, këto ditë, në të njëjtin universitet, diplomoi me sukses të lartë në nivelin e vlerësimit „Ekselent“. Ai u dallua në mesin e pjesëmarrësve të rreth 20 ushtrive të vendeve nga tri kontinente.

FSK-ja mban ligjërata në shkollat fillore për vetëdijesimin e nxënësve ndaj mjeteve të pashpërthyera

Në disa nga shkollat fillore të komunave Prishtinë, Klinë dhe Malishevë, instruktorët e Kompanisë së Deminimit të FSK-së, edhe këtë vit, që nga 20 shkurti i vitit 2019, kanë filluar mbajtjen e ligjëratave për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve të pashpërthyera.

Këto ligjërata po realizohen në bazë të planit të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes me drejtoritë e arsimit të të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Ligjëratat e para për këtë vit u realizuan në shkollën fillore “Tre Dëshmorët” në fshatin Jashanicë e Ulët dhe në paralelen e saj të ndarë në Jashanicë të Lartë, në Komunën e Klinës. Gjatë këtyre ligjëratave, interesimi i nxënësve ishte i madh për t’u pajisur me njohuri rreth mjeteve të pashpërthyera dhe rreziqeve të mundshme nga to, si dhe përdorimin e procedurave standarde në rastet kur i hasin ato. Instruktorët e deminimit aktivitetin për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve të pashpërthyera do ta vazhdojnë nëpër shkollat e Republikës së Kosovës deri më 4 mars 2019.



Ushtria e Kosovës merr pjesë në stërvitjet dimërore në Turqi

Në qytetin Kars të Turqisë, ka filluar ushtrimi fushor ndërkombëtar „WINTER EXERCISE 19“ (Ushtrimi dimëror) në të cilin po marrin pjesë përfaqësues nga 13 shtete. „Ushtrimi dimëror 19“ ka për qëllim testimin e kapaciteteve luftarake në kushte të dimrit (borë me trashësi deri 50 cm dhe temperatura deri -20 gradë celsius), si dhe forcimin e ndërveprimit në mjedise të përbashkëta operacionale.



FSK-ja po merr pjesë me një kontingjent prej shtatë pjesëtarësh të rangut; oficerë dhe nënoficerë-stafi. Kontingjenti i FSK-së, ka zbarkuar më datën 06 shkurt 2019 dhe i është bashkuar Brigadës së 14-të të Mekanizuar të Ushtrisë Turke, në detyra të ndryshme, si oficerë/nënoficerë stafi, etj.

Komandanti i Kontingjentit të FSK-së, majori Albert Kuqi, deklaroi se; „Të gjithë oficerët dhe nënoficerët e FSK-së, janë në nivel të detyrës duke treguar profesionalizëm gjatë realizimit të këtij ushtrimi të përbashkët operacional. Qëllimi i pjesëmarrjes së FSK-së, është që pjesëtarët tanë të trajnohen dhe zhvillojnë shkathtësitë e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimeve, ku përfshinë; qitje reale nga armët e kombinuara të kalibrave të ndryshme në një operacion konvencional ushtarak, si dhe këto përvoja t'i aplikojmë në vendin tonë në kushte dhe ambiente të ngjashme“, shtoi major Kuqi. Ushtrimi „WINTER EXERCISE 19“ do të përfundojë më 22 shkurt 2019.

Operacion i përbashkët i ekspertëve amerikanë dhe të FSK-së për demolimin e mjeteve të pashpërthyera



Specialistët e Ekipeve për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera Eksplozive(EOD) të Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në bashkëpunim me specialistët e Ekipit të EOD-së, nga kampi amerikan „Bondsteel'', kanë realizuar një operacion të përbashkët për shkatërrimin e mjeteve eksplozive, të cilat janë gjetur nga ekipet e EOD-së në rajone të ndryshme të Kosovës.

Në këtë operacion janë demoluar 16 mjete të kalibrave të ndryshëm, të cilat kanë qenë rrezik permanent për jetën e qytetarëve. Demolimet janë realizuar në fshatin Halilaq, të organizuar në dy cikle. Operacioni i demolimit ka shkuar sipas planifikimit dhe është realizuar me sukses. Për të përcjellë nga afër këtë operacion, prezent ishte edhe komandanti i kampit „Bondsteel'', koloneli Macaraeg, koordinatori për Deminim nga „Film City, A. Cipri, zëvendëskomandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), nënkolonel Bajram Bekteshi, si dhe komandanti i Kompanisë së Deminimit, major Gëzim Sada. Të pranishmit u ndan të kënaqur me punën dhe angazhimin e ekspertëve të EOD-së dhe vlerësuan lart bashkëpunimin e ndërsjellë të FSK-së me KFOR-in.



Interesim i madh i të rinjve për shërbim aktiv në Forcën e Sigurisë së Kosovës



Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, më datë 11-22 shkurt 2019, ka shpallë zyrtarisht konkursin publik për rekrutimin e rekrutëve (OR1) - ushtarëve që do të shërbejnë në komponentin aktiv të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Konkursi u shpall mbi bazën e Planit të Veprimit 2019 të Ministrisë së Mbrojtjes. Bazuar në këtë plan, po zhvillohet edhe procesi i shqyrtimit, filtrimit dhe përzgjedhjes së rekrutëve të rinj që do të pranohen në FSK. Kriteret e përgjithshme për rekrut/OR1(ushtar) të FSK-së do të jenë:

Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; të këtë të përfunduar shkollën e mesme; të jetë i moshës 18-23 vjeç; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore e fizike për vendin e shërbimit si dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë. Procedurat e shqyrtimit, filtrimit dhe përzgjedhjes do të jenë: Shqyrtimi fillestar i aplikacioneve; testi i aftësive; testi fizik; intervista me shkrim dhe me gojë; testi mjekësor; trajnimi; verifikimi; emërimi si dhe e drejta e ankesës. Dokumentet e kërkuara për aplikim sipas konkursit janë: Diploma (dëshmi) e shkollimeve të përfunduara; dëshmi; certifikata; mirënjohje (nëse posedon); certifikata e lindjes (jo me e vjetër se 6 muaj); certifikata e shtetësisë; vërtetimi nga gjykata që nuk është nën hetime apo i ndjekur penalisht; kopje e letërnjoftimit apo pasaportës si dhe dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm). Shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët konkurrojnë mund të pranohen në Forcën e Sigurisë së Kosovës pasi të kenë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes.

Pranimi në FSK konfirmohet pas përfundimit të trajnimit bazik dhe gjatë kësaj kohe kandidatët do të cilësohen si rekrutë (OR1). Pas përfundimit të trajnimit bazik rekrutët marrin gradën e ushtarit. Interesimi i të rinjve për ta mveshur uniformën e FSK-së, ishte shumë i madh flet vet fakti se gjatë 11 ditëve kanë aplikuar mbi 6759 veta, prej tyre 451 janë femra dhe 174 pjesëtarë të komuniteteve.

Certifikohen kursantët e kursit bazik “Mbijetesa në Dimër”



Në Qendrën Trajnuese për Kërkim-Shpëtim, dje u mbajt ceremonia e certifikimit për pjesëtarët e FSK-së, të cilët përfunduan me sukses kursin “Mbijetesa në Dimër/ Mot të Ftohtë’ në terren të hapur. Pjesëmarrësit në kursin dimëror përfaqësonin të gjitha njësitet e FSK-së, përfshirë: BRSH-në, PF-në, TFKSH-në dhe Komponinë e Deminimit.

Qëllimi i mbajtjes së kursit, me intensitet të lartë, ishte përshtatja dhe mbijetesa në kushte ekstreme të motit. Gjithashtu gjatë trajnimit pjesëmarrësit janë mësuar me ndërtimin e strehimoreve për mbijetesë me materialin e gjendur në natyrë, metodat e ndezjes së zjarrit dhe sigurimin e ujit dhe të ushqimit. Pjesëmarrësit e trajnimit janë përgatitur edhe për orientimin në natyrë, pa harta dhe busulle, vetëm duke u orientuar përmes diellit, hënës, yjeve dhe objekteve të tjera në natyrë. Finalizimi i kursit ishte marshimi i pjesëmarrësve në kushte ekstreme të ftohta, në gjatësi mbi 8 km, ku ata kaluan 36 orë, jashtë, në natyrë, duke praktikuar mësimet e mësuara.

Në ceremoninë e certifikimit ishte i pranishëm edhe komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri, i cili uroi pjesëmarrësit për përfundimin me sukses të këtij kursi shumë të vështirë. Kurse, drejtori i QTKSH-së, Joni, i uroi pjesëmarrësit për disiplinën dhe përkushtimin e treguar gjatë trajnimit. Pjesëtarët e FSK-së, të cilët arritën ta përfundojnë me sukses trajnimin, tani janë të gatshëm që po ashtu me suksesi t’i bartin njohuritë e fituara te njësitet dhe kolegët e tyre.

Të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit kanë arritur t’i plotësojnë kriteret e kursit, dhe janë certifikuar për Nivelin e Avancuar të Kursit “Mbijetesa në kushte të vështira dimri”.

FSK-ja shkatërron ortekët e borës në Brezovicë

Në një lartësi mbidetare mbi 2230 metra dhe mot të keq, ekipet e Kërkim-Shpëtimit dhe të Deminimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, kanë realizuar me sukses misionin e tyre për largimin e ortekëve të borës. Ishte mision i vështirë, por i realizueshëm për ekipet profesionale të FSK-së. Këta ortekë për fat të keq, para ca ditësh morën edhe jetë njerëzish.

Pas vlerësimit të situatës nga ekipet e Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, ekipet e Deminimit, me gjithë kushtet e vështira, kanë filluar punën më datë 02.02.2019 për largimin e ortekëve të rrezikshëm të borës në kompleksin turistik në Brezovicë. Së pari shkatërruan ortekun e parë me eksploziv, i cili paraqiste rrezik të madh për krijimin e një orteku edhe më të madh dhe shumë të rrezikshëm për qytetarët. Për shkak të motit shumë të vështirë dhe erërave të forta, deri në 60km/h, operacioni është dashur të ndërpritet. Operacioni ka vazhduar më datën 04.02.2019, me ç ‘rast është larguar edhe orteku i dytë.



Sipas vlerësimeve për momentin nuk ka rrezik potencial për lëvizje të ortekëve, mirëpo duke u bazuar në kushtet atmosferike të cilat mbretërojnë në këtë pjesë mund të krijohen ortekë të cilët mund të paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve. Vështirësitë në terren kanë qenë shumë të mëdha, por falë përgatitjes profesionale të ekipeve të FSK-së, dhe falë vullnetit të madh, për të mos lejuar të ndodhë ndonjë katastrofë natyrore për vizitorët në këto pjesë, është arritur që operacioni i ekipeve të Deminimit të kryhet me sukses.



Zhytësit e FSK-së nxjerrin trupin e pajetë të qytetarit E.Sh. nga liqeni i Livoqit



Një skuadra e Kërkim-Shpëtimit në Ujëra e Forcës së Sigurisë të Kosovës, me vendim të ministrit të Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha, dhe me urdhër të komandantit të Ushtrisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më datë 02 shkurt 2019 (e shtunë), angazhohen që nga ora 22:03, në vlerësimin e gjendjes në liqenin e Livoqit (komuna e Gjilanit), pas njoftimit nga Policia e shtetit për dyshimin se aty, kishte rënë një person me inicialet E.Sh. nga Gjilani.

Pas vlerësimit të gjendjes dhe planifikimit të detajuar, operacioni i kërkimit nga zhytësit e FSK-së, ka filluar më datë 03.02.2019, në ora 09:00, të cilët pas një pune vetëmohuese, duke u përballur edhe me kushtet e vështira atmosferike të shkaktuara nga ngricat dhe akulli mbi liqen, por edhe falë profesionalizmit të tyre, arritën që të identifikojnë lokacionin, dhe të nxjerrin në breg trupin e personit të shpallur në kërkim. Trupi i pajetë i personit E.Sh. i është dorëzuar Policisë së Kosovës dhe ekipeve të Mjekësisë Ligjore për procedura të mëtejshme.

Siç na njoftoi kapteri Naim Mala, ekipet e FSK-së, pas operacionit të suksesshëm janë kthyer në repartet e Kazermës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK në Pomozotin.

FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 78 • 11 Prill 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i FSK-së morën pjesë në shënimin e 10- vjetorit të Shqipërisë në NATO

Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe Komandanti i Ushtrisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të ministres së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë zonjës Olta Xhaçka, më 29.03.2019, morën pjesë në shënimit e 10-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Në Tiranë, ministri Berisha në fjalën e tij tha: „Jemi shumë të nderuar që bashkë me komandantin e FSK-së dhe stafin e Ministrisë, po marrim pjesë në shënimin e 10-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, duke e konsideruar edhe si vendim historik për rajonin e Ballkanit. Jemi të lumtur që Shqipëria sot, gjendet krah përkrah me shtetet aleate në misione të ndryshme paqeruajtëse në vende të ndryshme të botës.

Por, ne jemi të gëzuar edhe për pranimin e shteteve të tjera të rajonit në NATO, anëtarësimi i



tyre si dhe shteteve të tjera në të ardhmen ndihmon paqen dhe stabilitetin në rajon. Edhe Kosova objektiv strategjik ka anëtarësimin në NATO". Ministri Berisha gjithashtu i ka njoftuar të pranishmit edhe me zhvillimet e fundit në Kosovë, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke theksuar: „Kuvendi i Kosovës me votë unanime, në fund të vitit të kaluar ka miratuar tri ligjet që i japin Forcës së Sigurisë të Kosovës mandat të ri. Ky vendim, është vendim sovran i shtetit të Kosovës i njohur nga 118 vende të botës dhe nga Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë më 2010. Prej 21 janarit të këtij viti, kemi filluar realizimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit, plan ky që do të jetë transparent, gradual 10-vjeçar, ku zbatimi i këtij plani do të ndodhë në tri faza.

FSK-ja, edhe me mandatin e ri, do të jetë institucion profesional, i besueshëm dhe shumetnik. Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja kanë bashkëpunim shumë të mirë me KFOR-in në Kosovë dhe nuk e kontestojmë asnjëherë mandatin e KFOR-it në Kosovë. U jemi shumë mirënjohës të gjitha shteteve që përmes KFOR-it kanë dhënë kontribut 20-vjeçar për një mjedis më të qetë dhe të sigurt në Kosovë. Të gjitha të arriturat e deritashme, janë meritë e një bashkëpunimi të afërt me KFOR-in dhe NATO-në në Kosovë. Përkundër rrugës tragjike nëpër të cilën ka kaluar Kosova, ne jemi të përkushtuar të punojmë për paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë dhe që tani jemi të gatshëm me kapacitetet që posedojmë dhe ato qe do t'i ndërtojmë, të mos jemi vetëm konsumues por edhe kontribuues të sigurisë". Në këtë aktivitet morën pjesë ministra Mbrojtjes, shefa shtabesh, gjeneralë të vendeve anëtare dhe të komandave të NATO, ambasadorë dhe atashe ushtarakë të akreditуar në Tiranë.


Gjenerallejtënant Rrahman Rama vlerësoi lart procesin e testimit dhe vlerësimit të kandidatëve për rekrutë të FSK-së



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, dje (20.03.2019) vizitoi kazermën „Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, duke u njohur nga afër me procesin e testimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, që kanë konkurruar për t'u bërë ushtarë të Ushtrisë së Kosovës. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, në poligonin e stërvitjeve, takoi nga afër grupet e kandidatëve të cilët po zhvillonin testin e fitnesit fizik, si dhe ata që po kryenin procesin e testimit të njohurive të përgjithshme në ambientet e KDS-së. Gjeneral Rama vlerësoi se procesi dhe rrjedha e testimeve dhe vlerësimi i kandidatëve janë duke u zhvilluar në përputhje me proceduarat standarde operative të procesit të testimit dhe vlerësimit. Procesi i testimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t'u rekrutuar në FSK, në bazë të konkursit të Ministrisë së Mbrojtjes të datës 11 shkurt 2019, ka filluar më 04 mars 2019 dhe do të vazhdojë deri më datë 22 mars 2019, nga dy grupe në ditë, gjithsej 32 grupe kandidatësh. Faza e parë e testimit do të përfundojë me 22 mars, për të vazhduar më pas faza tjetër e testimit sipas standardeve të konkursit, ku pritet të pranohen 650 ushtarë të rinj, të cilët do të shërbejnë si ushtarakë profesionist në FSK.

Kapiteni i FSK-së Ismail Hoxha përzgjidhet instruktor në Akademinë Ushtarake Mbretërore „Sandhurst"

Bazuar në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) do të dërgojë oficerin, kapiten Ismail Hoxha, si instruktor në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst". Me këtë rast, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur në zyrën e tij, kapitenin Ismail Hoxha për t`i uruar suksese dhe për t'i ofruar përkrahje të vazhdueshme gjatë angazhimit të tij në këtë akademi, e cila cilësohet si njëra ndër akademitë ushtarake më prestigjioze në botë. Gjatë takimit, gjeneral Rama tha: „Kam nderin që t'ia dorëzoj flamurin e Kosovës



kapitenit Ismail Hoxha, i cili me angazhimin e tij si instruktor do ta përfaqësojë në mënyrë të denjë vendin tonë në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst". Procesi i përzgjedhjes së oficerëve për të qenë instruktorë në këtë akademi është tejet rigoroz, prandaj FSK-ja po dëshmon se në strukturat e saj ka kuadro të përgatitur dhe të trajnuar sipas standardeve të NATO-s, dhe të aftë për të dhënë kontribut në ngritjen e kapaciteteve edhe në akademitë ushtarake me renome botërore. Për më tepër, angazhimi i kapitenit Hoxha padyshim se do të kontribuojë në ngritjen e imazhit të FSK-së, jo vetëm në Mbretërinë e Bashkuar por edhe në mbarë botën. Kapiteni Ismail Hoxha në këtë akademi do të jetë i angazhuar për dy vite rresht, për të vazhduar më pas kontributin e tij në ngritjen e kapaciteteve trajnuese në FSK sipas mandatit të ri. Kontributi i Mbretërisë së Bashkuar që nga viti 2009 është i pazëvendësueshëm për zhvillimin dhe edukimin profesional të oficerëve të FSK-së.

Kryeministri Haradinaj përgëzoi kapitenin Hoxha

Kryeministri i Republikës së Kosovës zoti Ramush Haradinaj priti në takim kapitenin e FSK-së Ismail Hoxha, oficer i FSK-së, i përzgjedhur instruktor në Akademinë Ushtarake Mbretërore „Sundhurst" në Mbretërinë e Bashkuar. Në pritje ishin të pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama si dhe nënkolonel Jake White- këshilltar ushtarak i Komandantit të FSK-së, ushtarak nga Mbretëria e Bashkuar. Kryeministri Haradinaj, pasi e përgëzoi kapiten Hoxhën për përzgjedhjen e tij, u shpreh: "FSK-ja në vazhdimësi



po dëshmon se në strukturat e saj ka potencial të trajnuar sipas standardeve të NATO-s dhe të aftë për të dhënë kontribut për siguri dhe paqe. Edhe suksesi i kapitenit Hoxha është e një arritje e përbashkët e forcës sonë dhe aleatëve tanë strategjikë, siç është Britania e Madhe".

Në Ministrinë e Mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes priti kryesuesin e Asamblesë Parlamentare kanadeze të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes z. Rrustem Berisha ka pritur më 27 mars 2019, në takim deputetin federal të Kanadasë, njëherësh kryesues i Asamblesë Parlamentare kanadeze të NATO-s, z. Borys Wrzesnewskyj të shoqëruar edhe nga ambasadori i Kanadasë që mbulon edhe Kosovën z. Daniel Maksymiuk. Ministri Berisha, pasi falënderoi z. Wrzesnewskyj për ndihëm dhe përkrahjen e madhe të Kanadaja ka dhënë për Kosovën, e njoftoi edhe me zhvillimet e fundit, miratimin e ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. "Kuvendi i Kosovës, në mënyrë unanime ka miratuar tri ligjet për Ministrinë e



Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Përkrahja e marrë prej 107 deputetëve nga 120 sa ka Kuvendi, na ka bërë që të punojmë edhe më shumë në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive tona", ka thënë ministri Berisha. "Mandati i ri i FSK-së, do të ruaj karakterin profesional, me mision mbrojtës. Një Forcë e hapur për të gjithë qytetarët dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne jemi zotuar se rajoni do të ketë edhe një forcë aleate, të ndërveprueshme me aleatët dhe në shërbim të krijimit dhe ruajtjes së paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon dhe më gjerë, jo vetëm konsumues por edhe ofrues të paqes. Përkrahja e Kanadasë edhe në këtë proces është shumë domethënëse për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në",-u shpreh ministri Berisha. Z. Borys Wrzesnewskyj, ka falënderuar ministrin Berisha për informimin e detajuar lidhur me zhvillimet në MM dhe FSK dhe ka shprehur edhe njëherë përkrahjen e Kanadasë për proceset në të cilat po kalon Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës.

Komandanti i FSK-së takoi ambasadorin e Hungarisë



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, priti më 21.03.2019, në takim ambasadorin fuqiplotë të Republikës së Hungarisë në vendin tonë, diplomatin Laszlo Markusz. Në takim u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Hungarisë, si dhe për marrëdhëniet e mira dhe të frytshme ndërmjet të dy forcave respektive. Komandanti i FSK-së dhe ambasadori hungarez shprehën gatishmëri për vazhdimin e bashkëpunimit dhe identifikimin e aktiviteteve për thellimin e tij në të ardhmen. Pjesë e trajnerëve ishte edhe rreshter majori Bujar Gosalci nga Komanda e Forcave Tokësore, i cili me njohuritë dhe ekspertizën e pilotimit të helikopterit solli njohuri të dobishme rreth aerodinamikës së fluturakeve – helikopterëve, si dhe shpjegoi në detaje procedurat që duhet ndjekur për të përcaktuar një zonë për aterim të helikopterit.

Qendra Trajnuese për Kërkim-Shpëtim është model jo vetëm në Forcën e Sigurisë së Kosovës, por edhe në rajon, për gjithë-përfshirjen e njerëzve që me të vërtetë sjellin diçka të mirë dhe të dobishme në kuadër të zhvillimit profesional.

Ambasadori i Turqisë pritet nga Ministri i Mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës z. Rrustem Berisha priti në një takim njohjeje ambasadorin e ri të Turqisë në Kosovë z. Çagri Sakar.

Së pari, ministri Berisha i uroi detyrën e re ambasadorit Sakar dhe më pas e njoftoi rreth procesit të tranzicionit të FSK-së, duke thënë: „Votimi unanim i ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në nga Kuvendi i Kosovës, ka qenë një ngjarje historike për Kosovën dhe FSK-në. Ky votim ka treguar edhe njëherë për besimin e madh që gëzon ushtria e Kosovës tek qytetarët e saj, pa dallim nacionaliteti dhe etnie. Jemi të përkushtuar në realizimin e misionit si forcë shumetnike dhe profesionale në shërbim të paqes, stabilitetit, qytetarëve dhe në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit të Kosovës", ka shtuar më tej, z. Berisha. Ministri Berisha, gjithashtu e falënderoi ambasadorin Sakar edhe për ndihmën e vazhdueshme që Turqia ndër vite ka dhënë për Kosovën. „Përkrahja e shtetit turk në përgjithësi për Kosovën dhe në veçanti për FSK-në, është shumë e rëndësishme, andaj ju falënderoj për përkrahjen e deritanishme, duke besuar se kjo përkrahje do të vazhdojë edhe më tej nga ana e Turqisë "- shprehet Berisha. Ndërsa, ambasadori i Turqisë, z. Çagri Sakar, pasi e uroi ministrin Berisha personalisht për miratimin e ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, ai i përcolli ministrit edhe një Letër urimi, dërguar nga Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë z. Hulusi Akar, në të cilën ndër të tjera shkruante: "Turqia do të vazhdojë përkrahjen për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si me përkrahje financiare për ushtrinë ashtu edhe me programet për shkollimin dhe trajnimin e oficerëve dhe ushtarëve të FSK-së në akademitë ushtarake turke". Ambasadori Sakar gjithashtu e njoftoi ministrin Berisha edhe për vizitën që ministri i Mbrojtjes së Turqisë së shpejti do ta zhvillojë në Republikën e Kosovës.



Ministri Rrustem Berisha priti ambasadorin e Katarit Ali bin Hamad Al Marri



Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha priti në takim ambasadorin e Katarit jorezident për Kosovë, Ali bin Hamad Al Marri. Ministri Berisha, pasi i uroi mirëseardhje ambasadorit Al Marr, e njoftoi me procesin e tranzicionit të FSK-së dhe punën që po bëhet për ngritjen e kapaciteteve ashtu siç edhe është paraparë në planin e tranzicionit. "Votimi unanim i ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në nga ana e Kuvendit të Kosovës ka qenë një ngjarje historike për Kosovën dhe FSK-në. Ky votim ka treguar edhe njëherë për besimin e madh që gëzon ushtria e Kosovës tek të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim nacionaliteti dhe etnie." - ka thënë ministri Berisha. Më tej ministri Berisha ka shtuar: "Ministria e Mbrojtjes përkatësisht Forca e Sigurisë së Kosovës, vazhdon të jetë e përkushtuar në realizimin e misionit si forcë shumetnike, profesionale, në shërbim të paqes, stabilitetit, të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit të Kosovës". Ministri Berisha gjithashtu e ka falënderuar ambasadorin Al Marri për përkrahjen që ka dhënë në vazhdimësi dhe në të gjitha etapat Katari për Republikën e Kosovës. Ambasadori Al Marri, pasi ka uruar ministrin Berisha për miratimin e ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, ka shtuar: "Katari e konsideron Kosovën si shtet mik dhe do të vazhdojë përkrahjen për Kosovën dhe ushtrinë e saj ". Ai gjithashtu ka shprehur dëshirën për të shikuar mundësitë për vizita të ndërsjella ndërmjet dy ministrave të Mbrojtjes.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Gjeneral Irfete Spahiu vizitoi Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FA të Shqipërisë

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nga data 12 deri më 13 mars 2019, një delegacion i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes i FSK-së i udhëhequr nga gjeneral brigade Irfete Spahiu, komandant i KDS-së, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në KDS të FARSH-së në Tiranë. Qëllimi i vizitës ishte bashkëpunimi i dyanshëm në sferën e edukimit, në zhvillimin e programeve stërvitore dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet dy institucioneve.

Delegacioni FSK-së, gjatë vizitës dyditore, u prit nga komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Bajram Begaj dhe stafi i tij, me ç 'rast u njoftua nga afër me aktivitetet e KDS-së të FARSH-së, të cilat u prezantuan nga Akademia e Forcave të Armatosura, DASK (Dega e Arsimit/Stërvitjes dhe Kurrikulës) si dhe nga Shkolla e Trupës dhe Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit. Po ashtu, delegacioni vizitoi edhe Qendrën e Simulimit dhe Qendrën e Gjuhëve të Huaja.

Gjeneral Spahiu u prit në takim edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ku temë diskutimi ishte bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve përkatëse. Gjeneral brigade Irfete Spahiu, pasi shprehu falënderime për mikpritjen dhe mbështetjen që FARSH i ka dhënë ndër vite FSK-së, në veçanti KDS-së, ajo vlerësoi lart edhe përvojën e çmuar të fituar nga FARSH, bashkëpunimin e vazhdueshëm, si



dhe gatishmërinë për qasje të përbashkët në raport me partnerët si një nga prioritetet e së ardhmes.

Zëvendësministri Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama i ndanë medalje këshilltarit të NALT-it, kolonelit Dailey

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, më 14 mars 2019, u organizua një ceremoni përshëndetëse për shefin e deritashëm të këshilltarëve të NALT-it (Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për FSK-në) kolonelin Jamie Dailey, i cili përfundoi misionin njëvjeçar në FSK. Në këtë ceremoni të pranishëm ishin: zv. ministri Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, përfaqësues të NALT-it si dhe gjeneralë dhe pjesëtarë të lartë të Ministrisë dhe FSK-së.





Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Ramadani në emër të ministrit Berisha dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, falënderoi kolonelin amerikan, Jamie Dailey, për angazhimin dhe kontributin që ka dhënë gjatë shërbimit të tij për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, në kuadër të NALT-it. Me këtë rast, z. Ramadani veç tjerash shprehu mirënjohjen dhe falënderimin për kolonelin amerikan Dailey. "Ishte kënaqësi për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në që patëm rastin të bashkëpunojmë me kolonelin Daily. Jemi të bindur se rruga jonë është e sigurt, e mbështetur dhe në partneritet të plotë me NATO-n dhe SHBA-të", tha z. Ramadani. Zëvendësministri Ramadani i dha mirënjohje dhe medalje shefit të NALT-it për bashkëpunimin dhe kontributin e tij profesional në FSK.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, duke ia dhënë medaljen kolonelit Dailey, shprehu konsideratë të lartë për punën, kontributin, përkushtimin profesional dhe për bashkëpunimin me FSK-në. Në fund, shefi i deritashëm i këshilltarëve të NALT-it, koloneli amerikan, Jamie Dailey, u shpreh më se i lumtur për kohën gjatë shërbimit të tij në këtë detyrë, duke e falënderuar MM-në dhe FSK-në për bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë qëndrimit në detyrën e shefit të NALT-it.

Koloneli gjerman Heyman vizitoi kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë



Në mjediset e kazermës „Adem Jashari" në Prishtinë qëndroi për vizitë komandanti i kontingjentit gjerman në kuadër të KFOR-it në Kosovë, koloneli Nikol Jan Heyman. Koloneli Heyman u prit nga komandanti i Forcave Tokësor, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit koloneli Hasan Hoxha dhe rreshter majori Fetah Zjenullahu. Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral Enver Cikaqi, pasi e falënderoi kolonelin Heyman për vizitën dhe ndihmën e pakursyer të shtetit gjerman për FSK-në, e njoftoi edhe me të arriturat e përgjithshme të Komandës së Forcave Tokësore. Ndërsa, majori Dedë Hiseni, në një takim informues e njoftoi kolonelin Heyman dhe ekipin e tij me misionin, strukturën, trajnimet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të FSK-së.

Koloneli Heyman dhe ekipi i tij, të shoqëruar nga koloneli Hasan Hoxha, vizituan Qendrën e Mësimit të Gjuhëve të Huaja, Kompaninë e Komunikimit dhe Servisin e Automjeteve në Brigadën e Mbështetjes Operacionale. Në Qendrën e Mësimit të Gjuhëve të Huaja ata takuan pjesëtarët e FSK-së, të cilët po ndiqnin mësimin e gjuhës gjermane, realizimi i së cilës është mundësuar nga Ambasada gjermane në Prishtinë, me ç 'rast takuan edhe mësuesen e gjermanishtes, e cila i njoftoi me planin e realizimit të nivelit të gjuhës gjermane.

Delegacioni gjerman gjithashtu vizitoi edhe Kompaninë e Komunikimit, ku nga komandanti i saj, kapiten Fatmir Kajtazi, u njoftuan me misionin dhe detyrat e kompanisë. Më pas ata vizituan edhe Servisin e Automjeteve, për të parë nga afër pajisjet dhe shërbimet që ofrohen në këtë servis për mirëmbajtjen e automjeteve të FSK-së. Delegacioni gjerman u nda mjaft i kënaqur me mikpritjen dhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së.

Ushtria e Turqisë mban seminarin „Mirëmbajtja bazike në FSK"



Në kazermat e Brigadave për Reagim të Shpejtë të Forcës së Sigurisë të Kosovës, përkatësisht në Batalionin e Parë të Reagimit të Shpejtë në Gjilan, në Batalionin e Dytë në Istog dhe në Batalionin e Tretë të Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë, nga data 11 deri më 14 mars 2019, u mbajtën seminare me temë: Mirëmbajtja bazike në FSK. Seminaret u zhvilluan nga ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në kuadër të bashkëpunimit ushtarak të kryesisë së Këshillit turk në Kosovë.

Në kazermën "Adem JASHARI" u mbajt ceremonia



Në kazermën „Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, u mbajt manifestimi qendror në shënim të 21- vjetorit të „Epopesë së UÇK-së", në nderim dhe përkujtim të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Manifestimi për shënimin e Epopesë ë UÇK-së, më 5,6 dhe 7 mars 2019, po mbahet nën përkujdesjen e kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Në ceremoni ishin të pranishëm presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, Rifat Jashari vëllai i komandantit legjendar Adem Jasharit, si dhe personalitete shtetërore dhe ushtarake të Kosovës, ministra dhe diplomatë, përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, deputetë, veteranë, invalidë, qytetarë dhe nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës.

Pas revistës që iu bë kuadrateve të FSK-së nga presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe pas intonimit të himnit shtetëror dhe atij kombëtar, presidenti Thaçi, kryeministri Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Berisha, komandanti i FSK-së gjeneral Rama dhe kryetari i veteranëve të UÇK-së z. Ngucati vendosën kurora me lule pranë Obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri.

Në fjalën e tij, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pos tjerash tha: „Sot kujtojmë sakrificën e pashembullt të familjes Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Kjo sakrificë sublime, bëri kthesë të jashtëzakonshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Bota filloi ta kuptojë drejtë Kosovën. Epopeja e UÇK-së dëshmoi se kthim prapa nuk kishte në luftën tonë për liri dhe çlirim. UÇK-ja u bë projekti më madhor kombëtar në historinë e kombit shqiptar". Presidenti Thaçi, më tej, shtoi se: „Sot dhe gjithmonë nderojmë të gjithë dëshmorët e lirisë, invalidët, veteranët dhe gjithë qytetarët që sakrifikuan për çlirimin e Kosovës. Nderojmë diasporën, që dhanë gjithçka për liri. Kujtojmë 13500 civilë shqiptarë të vrarë, rreth 400 masakra kundër shqiptarëve, rreth 20000 gra të dhunuara shqiptare. Në këtë përvjetor për herë të parë Epopenë e UÇK-së, po e shënojmë me ushtrinë e Kosovës, të njohur edhe ndërkombëtarisht si





Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i FSK-së bëjnë homazhe te Memoriali Përkujtimor në Prekaz



Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama të shoqëruar edhe nga zv. ministrat Burim Ramadani dhe Agim Çeku, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralë, oficerë të FSK-së, si dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë bënë homazhe te varri i komandantit legjendar Adem Jashari dhe familja Jashari, për nder të „Epopesë së UÇK-së". Me këtë rast, ministri Berisha tha: „Ky përvjetor është më i veçantë, pasi që po shënohet bashkë me ushtrinë e Kosovës. Jemi këtu për të nderuar të gjithë ata që vlerësuan se liria e vendit është më e shenjtë se jeta e tyre dhe e familjarëve të tyre. E veçanta e këtij përvjetori është se ne kësaj radhe vijmë me një mandat të ri, me një mision të ri, vijmë si Ministri e Mbrojtjes dhe me mandat ushtarak, që ishte edhe synimi i të rënëve që sot po i kujtojmë",- tha ministri Berisha. Pas homazheve, delegacioni i Ministrisë dhe FSK-së, u prit edhe në Kullën e Jasharëve nga kryefamiljari Rifat Jashari.

ushtarake në nderim të „Epopesë së UÇK-së”







forcë moderne, profesionale dhe shumetnike. Ecja e Kosovës përpara është e pandalshme. Po konsolidohemi në rrafshin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Të bashkuar si popull dhe institucione kemi energji që të bëjmë hapa gjigantë. Të bashkuar miqtë do të na përkrahin edhe më shumë”, ka përfunduar fjalën e tij, duke shtuar se në të ardhmen e afërt Kosova do të bëhet pjesë e NATO-s, Bashkimit Evropian, OKB-së dhe do t’i forcojë raportet speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës“.

Ndërsa, kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në fjalën e tij, tha: „Në marsin e 1998-ës midis Evropës u shua një familje e tërë, por bota e lirë u zgjua dhe nuk lejoi të zhduket një popull, i cili, nga historia evropiane dhe botërore kishte mësuar ndër breza të jetojë i lirë, në vend të vetin, me nder dhe dinjitet dhe duke i respektuar të tjerët që jetojnë pranë tij. Heronjtë dhe dëshmorët e Kosovës, veçanërisht Jasharët dhe komandanti legjendar Adem Jashari, na kanë dhënë këtë leksion: Vetëm një popull që është i gatshëm ta mbrojë lirinë me çmimin e jetës, e ka të ardhmen e sigurt“!

Kurse për themelimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë, kryeministri Haradinaj, shtoi: „Vota për Ministrinë e Mbrojtjes, për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe për shërbimin në këtë forcë, e lartësoi emrin e atdheut. Të zgjedhurit e popullit të Kosovës, me 107 vota i thanë po një projekti nacional që vjen në formë euroatlantike, që ka qëllim paqen dhe që i dedikohet paqes. Shërbimi në Forcën e Kosovës do të jetë nder e privilegj, por edhe patriotizëm i gjithë qytetarëve që jetojnë në Kosovë edhe atyre të komuniteteve etnike .

Sot, këtu, ritakohen në rresht të gjithë brezat e çlirimtarëve të Kosovës, të mishëruar në flamurin e ushtrisë sonë të paqes dhe flamurtari i parë, eprori i të gjithë eprorëve, gjenerali ynë, gjenerali i gjithë gjeneralëve, Komandanti ynë Adem Jashari. Ushtria e Kosovës vjen në paqe dhe ajo nuk do të përdoret kundër popullit të Kosovës, as në jug dhe as në veri. Por ajo do të jetë aty për paqe për të gjithë që jetojnë në Kosovë. Në miqësi të përhershme me Amerikën dhe në partneritet me aleatët tanë strategjikë, ne do t’ia dalim ta bëjmë Kosovën çfarë e ëndërruan çlirimtarët“, tha në fund kryeministri i Kosovës, z. Haradinaj.

Në ceremoninë ushtarake Rifat Jashari, vëllai i komandantit Adem Jashari, duke uruar të gjithë, për formimin e ushtrisë së Kosovës, tha se; dëshiron që këta ushtarë të jenë të gatshëm gjithmonë të mbrojnë territorin e Kosovës, siç e ka mbrojtur Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ai fjalën e tij e përmbylli duke falënderuar të gjithë miqtë tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të gjitha shtetet e tjera, që na kanë ndihmuar dhe shpresoj që prapë do të na ndihmojnë tha Rifat Jashari. Në fund, Trupa muzikore e FSK-së, ekzekutoi disa pika muzikore. Manifestimi për Epopenë e UÇK-së, vazhdoi edhe më 6 dhe 7 mars, me homazhet në Kompleksin Memorial në Prekaz, Akademinë Përkujtimore kushtua “Epopesë së UÇK-së, si dhe me Natën e Zjarreve”.

Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i FSK-së në manifestimin „Epopeja e Dukagjinit” në Gllogjan



Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, zëvendësministrat Agim Çeku dhe Burim Ramadani, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, së bashku me një delegacion të gjerë nga Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, morën pjesë në manifestimin „Epopeja e Dukagjinit” me rastin e 21-vjetorit të fillimit të luftës së UÇK-së në Dukagjin dhe 20- vjetorit të fillimit të fushatës ajrore të NATO-s mbi caqet serbe për të ndalur fushatën e gjenocidit etnik në Kosovë.

Në fillim, ministri Berisha dhe delegacioni i lartë i Ministrisë dhe FSK-së vendosën buqeta lulesh të freskëta te kompleksi “Dëshmorët e Kombit” në Gllogjan, si dhe u pritën në oden e udhëheqësit të luftës në Dukagjin, tani kryeministër i Kosovës, z. Ramush Haradinaj.

Në manifestimin qendror të „Epopesë së Dukagjinit”, foli edhe president i vendit, Hashim Thaçi, përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, si dhe personalitete politike, institucionale e ushtarake. Në emër të ushtrisë, përshëndeti komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama i cili tha: ”Në emër të të gjithë oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës, kam nderin dhe privilegjin e veçantë që sot, në përvjetorin e 21-të të Epopesë së Lavdishme të UÇK-së të Zonës së Dukagjinit të iu drejtohem në cilësinë e Komandantit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, tani ligjërisht me mandatin e ushtrisë së rregullt, ideal ky jetik i djemve dhe vajzave luftëtare të lirisë, sot dëshmorë që prehen të qetë në përjetësi dhe ideal i veçantë i Bacës tonë madhështor- Bacës Hilmi”. „Koincidenca në mes Betejës së Gllogjanit dhe, saktësisht një vit pas, e fillimit të fushatës ajrore të NATO-s mbi caqet serbe për të ndalur fushatën e gjenocidit etnik në Kosovë, jep shembullin e duhur të luftës çlirimtare dhe ndërlidhjen me operacionet humanitare dhe paqeruajtëse të Aleancës Veri-Atlantike, garantueses të sigurisë dhe mbrojtjes më të fuqishme të vlerave më të larta civilizuese dhe demokratike në Botë” përfundoi fjalën e tij, gjeneral Rama.

Drejtori i Politikave dhe Planeve të MM Faruk Geci vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes të Hungarisë



Drejtori i Politikave të Mbrojtjes i Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës, zoti Faruk Geci, në kuadër të zhvillimeve të takimeve dypalëshe takoi Ndihmës Sekretarin e Politikave të Mbrojtjes së Hungarisë në Budapest. Qëllimi i takimit ishte thellimi i bashkëpunimit dypalësh, njoftimi me procesin e tranzicionit të FSK-së, me mandat të ri, si dhe mundësitë e bashkëpunimit me aktivitete operacionale në kuadër të dy ushtrive. Drejtori Geci dhe ekipi nga Ministria e Mbrojtjes njoftuan gjithashtu partnerët hungarezë edhe me situatën e sigurisë dhe të mbrojtjes në vend dhe rajon. FSK-ja e trajnuar për mandat të ri me standarde të NATO-s do të jetë pjesë e afrimit të sigurisë në vend dhe më gjerë, tha zoti Geci.

U mbajtën garat për zgjedhjen e ushtarit më të mirë në Brigadën e Mbështetjes Operacionale

Në ambientet e kazermës „Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore, është mbajtur ceremonia e garës së ushtarit më të mirë në kuadër të Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO). Në ceremoni të pranishëm ishin: komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i BMO-së, gjeneral brigade Naim Haziri, zv. komandanti i BMO-së, kolonel Avdi Rraci, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, komandantët e batalioneve të BMO-së, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Komandanti i BMO-së, gjenerali Naim Haziri u shpreh i kënaqur me mbajtjen e kësaj gare, ku theksoi se "vetë prezenca e komandantit të Komandës së Forcave Tokësore dhe e juaja oficerë të nderuar tregon për interesimin tuaj për këtë aktivitet në kuadër të brigadës. I përgëzoj organizatorët dhe rreshter majorët që kanë punuar gjatë gjithë kohës për organizimin e garës, në veçanti i falënderoj pjesëmarrësit e kësaj gare. Gjatë realizimit të garës kam parë përkushtimin e secilit prej jush për të dhënë më të mirën, duke shprehur aftësitë dhe shkathtësitë tuaja si në punë individuale ashtu edhe grupore".

Në emër të FSK-së, foli rreshter majori i komandantit të FSK-së, Genc Metaj, i cili pasi falënderoi të pranishmit në ceremoni dhe organizatorin e garës për mbajtjen e saj me sukses, ndër të tjera, tha: "na presin sfida të tjera në organizimin e garës tashmë ndërkombëtare, e cila do të organizohet në nivel të FSK-së, në fund të muajit prill 2019. Kjo garë në kuadër të BMO-së është vetëm parapërgatitje për garën finale me karakter ndërkombëtar". Ndërsa, rreshter majori i Brigadës së Mbështetjes Operacionale, Besim Berisha, tha:„Gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë, është mbajtur nga data 12 mars deri më 14 mars 2019, në këto disiplina: njohuri të përgjithshme, testi fizik, navigim tokësor, grup aktivitetesh si dhe marshimi prej 15 kilometrash me ngarkesë". Fitues të garës ushtari më i mirë në kuadër të BMO-së, janë shpallur tetari Labinot Vuniqi, Batalioni i Logjistikës, vendi i parë, tetari Besnik Nebihu, Regjimenti i Mbrojtjes Civile, vendi i dytë dhe, vendi i tretë i takoi ushtarit Mehdi Bajraktari nga Batalioni i Logjistikës.

Gratë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK festuan 8 Marsin



Me rastin e 8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, u organizua një takim me gratë që shërbejnë në Ministri dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Burim Ramadani së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarin e përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj, gjeneral Xhevahir Geci dhe gjeneral Naim Haziri uruan gratë e Ministrisë dhe të FSK-së. Zëvendësministri Ramadani, në emër të ministrit Berisha dhe në emër të Ministrisë, ka uruar gratë që shërbejnë në Ministri, ushtaret dhe oficeret e Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe ushtaret e NATO-s. Ai njëherësh i ka përgëzuar ato për angazhimin, punën profesionale dhe sukseset në punën e tyre në Ministri dhe FSK. „Sot me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas- 8 Marsit, uroj të gjitha gratë e Kosovës dhe në veçanti gratë ushtare të Kosovës dhe të vendeve të NATO-s. Gratë dhe burrat e Kosovës kanë ndarë sakrificën për lirinë dhe pavarësinë, kështu ndajnë përgjegjësinë për konsolidimin dhe zhvillimin e vendit. Andaj sot kujtojmë me respekt të gjitha ato gra që kanë dhënë jetën për lirinë''. Në fund, nga stafi i lartë i Ministrisë, në shenjë respekti të gjitha grave dhe vajzave që shërbejnë në Ministri dhe FSK, iu dhuruan nga një vazo me lule.

Certifikohen kursantët për liderë të avancuar dhe policë të forcës



Në mjediset e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, më 4 mars 2019, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët përfunduan kursin për liderë të avancuar dhe kursin për policë të forcës. Pjesëmarrës në Kursin e avancuar të liderit ishin pjesëtarë nga të gjitha njësitet e FSK-së, ndërsa Kursi i policisë së forcës u mbajt për pjesëtarët më të rijnë të PFSK-së. Këto kurse mbahen në kuadër të planit vjetor dhe kanë për qëllim zhvillimin profesional të pjesëtarëve të FSK-së. Disa nga temat të cilat kursantët e Kursit të avancuar të liderit mësuan, janë: Patrullimi ditën dhe natën; Ndërtimi i pikës së kontrollit; Udhëheqja e sulmit; Organizimi i pritës dhe reagimi në pritë; Lufta urbane, etj.

Kursantët e PF-së u njoftuan me procedurat e sigurisë së automjeteve, pararojën, si të bëhet hetimi i aksidenteve si dhe rifreskuan njohuritë për Kodin Disiplinor dhe Kodin Penal të Kosovës. Kursi i avancuar i liderit u finalizua me një ushtrim fushor, ku kursantët shfaqën njohuritë e fituara teorike në praktikë. Në ceremoninë e certifikimit ishte i pranishëm edhe komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu si dhe oficerë të lartë të KDS-së. Gjeneral Spahiu, uroi pjesëtarët e certifikuar si dhe i përgëzoi për motivin dhe disiplinën e treguar gjatë trajnimit, duke theksuar rolin e rëndësishëm të këtyre kurseve në zhvillimin profesional të tyre dhe në veçanti për institucionin e FSK-së.

FSK-ja zhvilloi kursin bazik për kërkim-shpëtim urban

Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në Pomozatin, më 4 mars 2019, ka përfunduar trajnimi dyjavor i Kursit bazik të kërkim-shpëtimit urban. Studentët pjesëmarrës të këtij trajnimi, kanë mësuar ,hyrjen, brenda ndërtesave të dëmtuara për të shpëtuar viktimat. Gjatë trajnimit studentët kanë mësuar si dhe pse rrënohen ndërtesat, qoftë nga shkaktari njeri apo edhe nga fatkeqësitë natyrore, dhe si të identifikojnë hapësirat në ndërtesat e rrënuara, ku viktimat kanë një mundësi të madhe për mbijetesë.



Elemente kyçe të trajnimit ishin mësimi i teknikave të shpimit të betonit dhe të prerjes së metaleve, për të krijuar qasje në strukturat e dëmtuara si dhe teknikat e kërkimit për të gjetur viktimat, përmes kamerave dhe ekipeve të specializuara të qenve K-9 të kërkimit. Gjithashtu, trajnimi përfshiu edhe punën e ngjitjes me litar dhe të përdorimit të litarit për të krijuar qasje nga lart në ndërtesa e dëmtuara.

Studentet kanë mësuar për emergjencat mjekësore të shpëtimit të jetëve dhe si t'i largojnë viktimat, në mënyrë të sigurt nga ndërtesat e rrënuara. Skenarë të ndryshme janë përdorur në mënyrë të tillë që studentët t'i praktikojnë në secilën fazë të trajnimit. Element i ri i këtij trajnimi ishte shfrytëzimi i tunelit të ri nëntokësor 30 m, që së fundi është ndërtuar nga vet stafi i QT-së. Ky tunel rrit më tej realitetin e programeve të trajnimit dhe numrin e skenarëve të mundshëm të trajnimeve. Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm përfaqësues nga Ambasada e SHBA-ve, ODC-ja, mbështetës të fuqishëm të punës së Qendrës së Trajnimit dhe stafi i Qendrës së Trajnimit, të cilët vlerësuan lart angazhimin dhe motivimin e studentëve gjatë mbajtës së kursit për kërkim-shpëtim urban.

Ushtarët e Batalionit të tretë mbajtën ushtrimin fushor „Skifteri 03"

Pjesëtarët e Kompanisë 3C të Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të Forcës së Sigurisë të Kosovës në kuadër të trajnimeve dhe aktiviteteve për vitin 2019, janë duke realizuar ushtrimin fushor „Skifteri 03'' në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Podujevës, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, Policinë e Kosovës dhe Kryqin e Kuq. Ushtrimi Skifteri 03 përmbyll trajnimin „Gjenerimi i Forcës'' i cili ka filluar më 8 janar 2019. Për të parë nga afër mbarëvajtjen e këtij ushtrimi sot (27.3.2019) në vendin ku është duke u realizuar trajnimi në Batllavë, kishin dalë: komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, shef i Departamentit për Operacione në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale gjeneral brigade Naim Haziri, kryetari i Komunës së Podujevës Agim Veliu, atasheu ushtarak amerikan, Christopher Konner, zv. komandanti i BRSH-së kolonel Hysen Dreshaj, komandanti i Batalionit të Tretë në Mitrovicë, nënkolonel Sylejman Cakaj si dhe përfaqësues të Policisë, AME-së dhe Kryqit të Kuq. Me këtë rast, gjeneral Cikaqi pasi falënderoi të gjithë të pranishmit për angazhimin dhe bashkëpunimin gjatë realizimit të këtij trajnim shtoi: ''Trajnime të tilla kemi realizuar edhe me komuna tjera, ku qëllimi i këtyre ushtrimeve është ndërveprushemria me kuvendet komunale dhe agjencitë tjera të emergjencave dhe sigurisë". Ndërsa, kryetari i Komunës z. Veliu, theksoi: "Bashkëpunimi i komunës me FSK-në-Ushtrinë e Kosovës gjatë këtij ushtrimi ishte shumë rëndësishëm. Në kuadër të tij janë realizuar disa konferenca të përbashkëta përgatitore. Në fillim të ushtrimit kemi ngritur shtabin e emergjencave, me të gjitha agjencitë e emergjencave në kuadër të Komunës se Podujevës, ku kapacitetet tona si komunë dhe agjencitë e emergjencave janë përballur me situata të ndryshme në bazë të skenarëve të planifikuara. Me rritjen e incidenteve kemi kërkuar ndihmën e FSK-së dhe kemi dorëzuar komandën dhe kontrollin tek autoritet e FSK-së, dhe jemi të kënaqur me bashkëpunimin e të gjitha agjencive pjesëmarrëse në këtë ushtrim fushor". Të gjithë të pranishmit patën mundësi të përcjellin nga afër disa nga intervenimet e përbashkëta të gjithë aktorëve pjesëmarrës, duke improvizuar incidente në Deminim në pendën e liqenit të Batllavës, në kordon kërkim në fshatin Orllan, intervenimin e zjarrfikësve dhe dhënien e ndihmës së parë nga Kryqit të Kuq në një aksident trafiku, kërkim-shpëtim në ujëra etj. Pas të gjithë këtyre operacioneve, ata të cilat patën mundësi t'i ndiqnin, u shprehën mjaft të kënaqur me këtë bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet institucioneve, si dhe shprehen gatishmëri që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe me tutje në rast të paraqitjes së ndonjë fatkeqësive.

FSK-ja teston aftësitë ndërvepruese me agjencitë civile në ushtrimin fushor „Skifteri 03"




Forca e Sigurisë së Kosovës njofton opinionin e gjerë se, bazuar në planin vjetor të ushtrimeve dhe stërvitjeve, Batalioni i Tretë i Reagimit të Shpejtë i Forcës së Sigurisë të Kosovës, me vendqëndrim në Mitrovicë, nga data 25 deri më 28 mars 2019, do të zhvillojë aktivitete stërvitore në kuadër të ushtrimit „Skifteri 03'' në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Podujevës, përkatësisht agjencitë civile të komunës për të testuar aftësitë dhe ndërveprimin e institucioneve në raste emergjente. Në këtë ushtrim, trupat e FSK-së, përkatësisht Batalioni i Tretë i Reagimit të Shpejtë, do të dislokohen nga kazerma në Mitrovicë në rajonin e Komunës së Podujevës, andaj konvojë të Forcës së Sigurisë së Kosovës do të shihen duke qarkulluar në rrugën magjistrale dhe lokale, dhe e tërë kjo do të bëhet me qëllim të stërvitjes dhe testimit të kapaciteteve dhe aftësive reaguese në ushtrim fushor të parapara sipas skenarit dhe planifikimit. Forca e Sigurisë së Kosovës gjithashtu i njofton qytetarët e rajonit të Mitrovicës dhe të rajonit të Prishtinës, se në asnjë formë nuk do të cenohen liria e lëvizjes dhe pronat e qytetarëve. Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendi Komunal i Podujevës kanë marrë të gjitha masat e nevojshme që ushtrimi të zhvillohet me sukses dhe të mos ketë asnjë shqetësim te qytetarët e këtyre dy rajoneve.

Qendra e Kërkim-Shpëtimit zhvilloi ushtrimin „Përcaktimi i zonës së aterrimit të helikopterit"

Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim Shpëtim të Regjimentit të Mbrojtjes Civile, më datë 20 mars 2019, u mbajt ceremonia e certifikimit e gjeneratës së parë të kursit "Përcaktimi i zonës së aterrimit të helikopterit". Trajnimi "Përcaktimi i zonës së aterrimit të helikopterit" ishte trajnim tre (3) ditor dhe kishte në fokus marrjen e njohurive bazike rreth principeve të përcaktimit të një zone të mundshme të aterrimit të një helikopteri. Në këtë trajnim u trajtuan tema që lidhen me aerodinamikën dhe funksionimin e helikopterëve; pastaj u shpjeguan në detaje kriteret e përzgjedhjes së një zone të përshtatshme për aterrim të helikopterëve; u shpjeguan komandat dhe sinjalet e komunikimit me pilotin para aterrimit; në hollësi u shtjellua kërkesat me nëntë linja, si dhe principet themelore të bartjes së viktimave me helikopter.

Edhe pse temat e trajtuara kërkojnë kohë më të gjatë, oficerët dhe nënoficerët që ndoqën trajnimin për një kohë kaq të shkurtër arritën të pajisen me njohuri bazike, që në të ardhmen varësisht prej misionit dhe operacioneve me të cilat do të ballafaqohen, mund të jenë në gjendje që të përcaktojnë një zonë të mundshme për thirrje të helikopterit në ndihmë, varësisht se në cilën zonë operojnë. Komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri u shpreh shumë i kënaqur që Qendra e Trajnimit po arrin të përmbushë gradualisht vizionin e të qenit qendër me perspektivë rajonale dhe më gjerë. Instruktorët, me profesionalizimin e tyre, për audiencën e trajnimit ofruan gjithçka nga eksperienca e tyre personale dhe profesionale.

Certifikohen pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës për përdorimin e automjeteve të rënda



Në kazermën „Skënderbeu" në Ferizaj u mbajt ceremonia e certifikimit të 4 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët ndoqën trajnimin „Testimi i sistemit të frenimit të kamionëve 5 tonësh", të realizuar nga rreshter majori Stefan Stieber i Ushtrisë gjermane nën përkujdesjen e përgjegjësve të Qendrës për Stërvitje Specialistike. Me rastin e përfundimit të këtij trajnimi ishin të pranishëm: komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale, gjeneral brigade Naim Haziri, zv. ambasadori i Ambasadës holandeze në Kosovë, z. Peter van Der Bloumen, zv. komandanti i Komandës dhe Doktrinës në Ferizaj, kolonel Mehmet Lladrovci, nënkoloneli gjerman Doutch, si dhe oficerë të tjerë të FSK-së. Rreshter majori gjerman, Stefan Stieber, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit me mbarëvajtjen e trajnimit, ndërsa pjesëtarët që u certifikuan demonstruan përdorimin e këtyre pajisjeve të frenimit. Me këtë rast, me një fjalë ju drejtua të pranishmëve KOMFT-së, gjeneral Cikaqi, i cili foli për rëndësinë e këtij trajnimi për FSK-në". Ambasada holandez këto pajisje të frenimit ia ka dhuruar FSK-së, që në nëntor të viti të kaluar, ndërsa sot për përdorimin e tyre po certifikohen 4 pjesëtarët e parë të FSK-së, të cilët janë trajnuar nga rreshter majori gjerman Steiber. Rëndësia e madhe e këtyre pajisjeve për FSK-në, dëshmon më së miri bashkëpunimin me miqtë tanë gjerman". I kënaqur me realizimin e këtij trajnimi u shpreh edhe zëvendës ambasadori i Ambasadës holandeze në Kosovë, z.Peter van Der Bloumen. "Prania e përfaqësuesve nga ushtritë e vendeve si Amerika, Gjermania, Turqia dhe Bullgaria dëshmojnë më së miri se sa e duam bashkëpunimin dhe zhvillimin e FSK-së, në përgjithësi. Gjithashtu falënderoj edhe njëherë rreshter majorin Stieber, i cili gjatë këtij trajnimi bëri një punë të mrekullueshme duke i aftësuar pjesëtarët tanë për përdorimin e këtyre pajisjeve". Këtë trajnim e vlerësoi lart edhe zv. KOMKDS-së, kolonel Mehmet Lladrovci, i cili ndër të tjera tha: "Edhe pse numri i pjesëmarrësve në këtë trajnim nuk ishte i madh, rëndësia e mbajtjes së tij ishte mjaft e madhe, pasi që këta katër pjesëtarë do të jenë pikënisje si në aspektin profesional të trajtimit të automjeteve, ashtu edhe të synimet tona për zhvillimin e këtij kursi në të ardhmen".

Trajnim i përbashkët i pjesëtarëve të FSK-së dhe të Forcave të Armatosura të Shqipërisë



Në kazermën „Evropianet e rinj" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Pomozotin, u mbajt sot (22.3.2019) ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së dhe atyre të FARSH-së, të cilët përfunduan me sukses „Kursin bazik për operacione malore kërkim-shpëtimi malor".
Në këtë trajnim dy javor, i cili filloj më 11.03.2019, morën pjesë 19 pjesëtarë, 10 nga ta ishin ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, dhe 9-të pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, të pranishëm ishin: komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale gjeneral brigade Naim Haziri, koloneli Përparim Gega nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri, si dhe oficerë të lartë të FSK-së. Komandanti i BMO-së, gjeneral Haziri, u shpreh mjaft i kënaqur me bashkëpunimin e FSK-së me FARSH-në. „Në situata të tilla ndihem jashtëzakonisht mirë, pasi që po kemi mundësi që të dy forcat tona të trajnohen së bashku, dhe dita ditës bashkëpunimi ynë po avancohet në të gjitha qendrat trajnuese si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri". Ndërsa, zv. komandanti i Komandës Mbështetëse të FARSH-së, koloneli Përparim Gega, në fjalën e tij, ndër të tjera tha: "Ndihem mjaft mirë që jam sot i pranishëm në një ceremoni të tillë shumë të rëndësishme, me ç 'rast ju falënderoj për bashkëpunimin dhe shpresoj që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tej me stërvitje dhe trajnime të tilla, në mënyrë që të jemi të gatshëm që të përballemi me çdo problem që na paraqitet". I kënaqur me realizmin e këtij trajnimi ishte edhe komandanti i RMC-së, koloneli Shaip Haziri. "Gjatë këtyre dy javëve të trajnimit ju arritët që të përmbushni çdo detyrë dhe obligim që patët, kjo na bënë që të mburremi me punën dhe angazhimin e instruktorëve të kësaj Qendre dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë trajnim. Uroj që këto njohuri që fituat t'i përdorni si një trup i vetëm gjatë krizave dhe katastrofave që shpresoj të mos na ndodhin asnjëherë". Trajnimi u realizua nga instruktorët e Qendrës së Trajnimit të Kërkim Shpëtimit. Gjatë trajnimit u realizuan këto tema: ndihmë e parë; ngritja në kullë; repelimi; trajtimi i viktimës; improvizimi i lesës; instalimi i litarëve (urave); tejkalimi i lumit; ngjitja e viktimës në maje; lëshimi i viktimës, navigim tokësor ditën dhe natën, etj. Gjatë realizimit të këtij trajnimi pjesëtarët i vizitoi edhe komandanti Forcave Tokësore gjenerali Enver Cikaqi, i cili i falënderoi instruktorët për punën e shkëlqyer që janë duke bërë në aftësimin e pjesëtarëve të rijnë, ndërsa pjesëmarrësit i përgëzoi për angazhimin dhe përkushtimin e treguar gjatë këtyre ditëve. Është hera e parë që realizohen trajnime të përbashkëta mes dy Forcave, ku pjesëtarët patën rastin të mësojnë nga eksperiencat e njëri–tjetrit.



Kompania e Deminimit filloi sezonin veror të çminimit të zonave të kontaminuar me mjete eksplozive

Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Kompania e Deminimit, në bazë të Planit të veprimit për vitin 2019, dje (26.03.2019) ka filluar sezonin veror të deminimit, duke pastruar zonat e minuara nga dora e njeriut si dhe ato të kontaminuar me bomba kasetore nga ajri. Për mbarëvajtjen dhe fillimin me sukses të këtyre operacioneve, FSK-ja ka marrë të gjitha masat e nevojshme. Operacionet e para të çminimit për këtë vit, FSK-ja i ka filluar në lokacionin e Soqishtës, Komuna e Hanit të Elezit, për të vazhduar më pas me Komunën e Ferizajt, përkatësisht lokacionin „Parku i Lirisë'' dhe hapësirën e kazermës „Skënderbeu'' të FSK-së, si dhe lokacionin Babaj i Bokës në Komunën e Gjakovës. Përveç operacioneve të deminimit, FSK-ja ka dy njësi për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera (EOD), gjithherë të gatshme 24 orë për 7 ditë të javës, për largimin e mjeteve të rrezikshme. Këto njësi kujdestare reagojnë në çfarëdo kohe sapo qytetarët të njoftojnë për praninë e këtyre mjeteve.
Deri më tani njësitë e EOD-së kanë intervenuar në 2700 raste dhe kanë demoluar mbi 4350 mjete të ndryshme eksplozive. Vlen të ceket se Kompania e Deminimit e Forcës së Sigurisë të Kosovës, pas përfundimit të sezonit të deminimit në fund të nëntorit 2018, gjatë periudhës së dimrit është përkujdesur për rifreskimin e njohurive të pjesëtarëve, duke organizuar trajnime në fusha të veçanta, si dhe ka organizuar mbajtjen e ligjëratave nëpër shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës, për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i minave dhe mjeteve tjera eksplozive. FSK-ja, prej fillimit të operacioneve të deminimit, pra qysh nga viti 2010, njësitë e saj kanë pastruar në 29 lokacione, me një sipërfaqe prej 2,191,201 metra katrorë dhe kanë gjetur 3512 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera. Si FSK, kjo na bën të ndihemi krenarë, aq më tepër se asnjë nga specialistë tanë nuk kanë pësuar lëndime gjatë ushtrimit të detyrës, gjë që dëshmon për profesionalizmin dhe motivimin e pjesëtarëve tanë gjatë punës në terren.
Nuk duhet të harrojmë faktin se që nga koha e luftës e deri më sot, 117 veta kanë humbur jetën si pasojë e minave dhe mjeteve tjera eksplozive, ndërsa 467 të tjerë janë lënduar, andaj puna e këtyre njësive është shumë e rëndësishme, dhe me të drejt mund të themi se çdo mjet eksploziv i çminuar është një jetë e shpëtuar.



FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 79 • 10 Maj 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Ministri i Mbrojtjes i Turqisë vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, z. Rrustem Berisha priti në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, z. Hulusi Akar. Ministri i Mbrojtjes i Turqisë, z. Hulusi Akar u prit me nderime të larta ushtarake nga Njësia Ceremoniale dhe Trupa Muzikore e FSK-së. Të dy ministrat, Berisha dhe Akar, së pari zhvilluan një takim të përbashkët, kokë më kokë. Më pas takimi vazhdoi në nivelin e zgjeruar të dy delegacioneve. Ministri i Mbrojtjes i Turqisë shoqërohej nga një ekip i gjerë bashkëpunëtorësh dhe zyrtarësh, kurse ministri Berisha shoqërohej nga komandanti i



FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, si dhe zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes. Në takimin e përbashkëte të të dy delegacioneve u prezantuan arritjet e përgjithshme të FSK-së, procesi i transformimit dhe perspektiva e zhvillimit sipas planeve të parapara. Po ashtu u bë edhe prezantimi i bashkëpunimit të deritashëm në mes të Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Turqisë si dhe të dy ushtrive përkatëse, duke evidentuar mundësitë e thellimit të bashkëpunimit të mëtejmë edhe në të ardhmen. Në fund të takimit të dy ministrat, Berisha dhe Akar, nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet dy ministrive të mbrojtjes, në të cilën përfshihen fushat me interes të përbashkët të bashkëpunimit.

Nënkolonel Ali Krasniqi akreditohet atashe i Mbrojtjes në Francë



Falë bashkëpunimit të shkëlqyer të Kosovës me Francën, Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës me Ministrinë e Armatave të Francës dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës me Ushtrinë e Francës, më 28 mars 2019, u bë akreditimi i atasheut të parë ushtarak të FSK-së në Republikën e Francës, nënkolonel Ali Krasniqi. Më 18 prill 2019, nënkoloneli Krasniqi, është pritur në takimin e parë zyrtar në Ministrinë e Armatave (Ministére des Armées), përkatësisht në Zyrën Ndërlidhëse me Misionet e Huaja (BLME) pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Strategji (DGRIS) nga koloneli Cyrille Barbie de Preaudeau, zëvendësshef i Zyrës Ndërlidhëse me Misionet e Huaja. Në këtë takim, koloneli de Preaudeau, foli për rëndësinë e akreditimit të atasheut të parë të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës në Francë. Po ashtu koloneli de Preaudeau e ka pajisur atasheun e FSK-së me një broshurë/guidë, në të cilën pasqyrohen të drejtat dhe përgjegjësitë e atasheve të mbrojtjes, pastaj organizimi i Armatave të Francës, me fokus organizimi i Forcave Tokësore etj. Gjatë pritjes, atasheu Krasniqi u njoftua edhe me Shoqatën e Atasheve të Mbrojtjes (CAMNA), e cila ka mbi 130 atashe të mbrojtjes dhe udhëhiqet nga gjenerali Halter, atashe i mbrojtjes nga Zvicra. Edhe atasheu i Kosovës, nënkolonel Krasniqi, pritet që shumë shpejt të bëhet anëtar i kësaj shoqate. Në ketë takim ishte i pranishëm edhe Renand Dorlhiac–Desk, oficer për shtetet e Ballkanit Perëndimor, i cili ka punuar për disa vite në Ambasadën e Francës në Tiranë. Në fund koloneli Barbie de Preaudeau, nënkolonelit Ali Krasniqi, i ka uruar detyrën, duke e bërë efektiv akreditimin e tij. Kështu atasheut Krasniqi, pas akreditimit i jepet mundësia që menjëherë të zhvilloi aktivitete dhe takime me interes për FSK-në dhe Kosovën, me të gjitha autoritetet relevante në Ministrinë e Armatave të Republikës së Francës.

Tetari Besnik Nebihu dhe rreshteri Xhevat Maloku shpallen ushtarët më të mirët për vitin 2019

Nën organizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës u mbajtën gara e FSK-së dhe gara ndërkombëtar për vitin 2019. Në këto gara morën pjesë 18 ushtarë-përfaqësues të 9 shteteve të NATO-s dhe 22 ushtarë-përfaqësues të të gjitha njësive të FSK-së. Ndër më të mirët në këto gara u shpallë: tetari Besnik Nebihu nga Briga e Mbështetjes Operacionale të FSK-së dhe rreshteri Xhevat Maloku nga Republika e Shqipërisë.

Ceremonia solemne e shpalljes së rezultateve „Ushtari më i mirë i vitit 2019" u mbajt në kazermën „Adem Jashari" në Prishtinë, në të cilën morën pjesë; zëvendësministri i Mbrojtjes Burim Ramadani, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i BMO-së, gjeneral brigade Naim Haziri, zv. komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Mehmet Lladrovci, komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri dhe oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, si dhe oficerë e atashe të shteteve partnere të FSK-së.

vijon në faqen e katërt



Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i FSK-së qëndruan për vizitë zyrtare në Kroaci



Ministri i Mbrojtjes z. Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes të Kroacisë, z. Damir Krsticeviq, po marrin pjesë në Panairin e 5-të të industrisë së armëve „ASDA 2019'', në Republikën e Kroacisë. Në Split, krerët e FSK-së morën pjesë në ceremoninë e hapjes së panairit si dhe vizituan disa prej kompanive më të njohura të pajisjeve ushtarake, ku panë nga afër kapacitetet dhe të arriturat më të fundit të teknologjisë ushtarake kroate. Ministri Berisha dhe komandanti Rama gjithashtu zhvilluan edhe disa takime dypalëshe me ministra dhe shefa të Mbrojtjes, pjesëmarrës në panair, me të cilët biseduan për procesin e tranzicionit të FSK-së, si dhe mundësitë e rritjes së bashkëpunimit në të ardhmen. Ekspozita Ndërkombëtare e Armatimeve dhe Pajisjeve Ushtarake (10-12 prill 2019) mbahet për herë të pestë në Split nën patronatin e Qeverisë së Kroacisë, organizuar nga „TNT Production Inc.'', nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës me mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë.

Gjenerali shqiptar Bajram Begaj u prit në Ministrinë e Mbrojtjes



Ministri i Mbrojtjes z. Rrustem Berisha, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe sekretari i përgjithshëm dr. Shkelzen Sylaj kanë pritur sot, në takime të ndara, komandantin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Bajram Begaj. Gjatë takimeve u çmua lart bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë si dhe bashkëpunimi i frytshëm dypalësh ndërmjet të dy forcave të dy vendeve tona si dhe u theksua nevoja për intensifikimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen, ndërmjet dy vendeve tona në fushën e mbrojtjes, me theks të veçantë në fushën e arsimimit edhe edukimit ushtarak modern. Vizita e gjeneralit Begaj në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet FSK-së dhe FARSH-së, ku një grup prej 25 pjesëtarëve të Kursit të Lartë të Oficeri, duke përfshirë edhe personelin pedagogjik të Departamentit të Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore po zhvillojnë një vizitë mësimore: „Promovimi i vlerave të ndërhyrjes ushtarake të NATO në Kosovë, roli i saj në çlirimin e Kosovës nga Serbia, si dhe rëndësia e vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare për njohjen e pavarësisë së saj''.

FSK-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit ndaj Minave



Në organizim të Qendrës Koordinuese për Deminim të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, më 4 prill 2019, u shënua Dita Ndërkombëtare e Ndërgjegjësimit ndaj Minave. Në shënimin e kësaj dite morën pjesë: zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Agim Çeku, kolonel Shaip Haziri komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, Ahmet Sallova, shef i Qendrës Koordinuese për Deminim në Ministrinë e Mbrojtjes, stafi i lartë i Ministrisë dhe FSK-së, përfaqësues të ambasadave të; SHBA-së, Norvegjisë, Zvicrës, Austrisë, Holandës dhe të organizatave; HALO Trust, NPA, MAT Kosova dhe KFOR-it. Zëvendësministri Agim Çeku, në emër të ministrit Berisha dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj ngjarjeje dhe falënderoi të gjithë ata që mbështetën dhe kontribuuan në pastrimin e Kosovës nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera. Zëvendësministri Çeku gjithashtu foli për rëndësinë e çminimit të mjeteve të pashpërthyera, si dhe për planin e pastrimit të Kosovës nga minat deri në vitin 2024. Zoti Çeku, më tej, tha se, ky projekt është shumë konkret dhe shumë i rëndësishëm dhe se në bashkëpunim me Qendrën e Deminimit në Gjenevë, është hartuar plani strategjik, i cili parasheh që deri në vitin 2024 do t'i pastrojmë të gjitha zonat e njohura të minuara dhe të afektuar nga bombat kasetore në Kosovë. „Institucioni më i besueshëm në Kosovë është FSK-ja, dhe njëra ndër të arriturat e saj më të mëdha është pikërisht operacioni i çminimit të minave dhe mjeteve tjera të pashpërthyera në Kosovë. Deri më tani njësitet e deminimit të FSK-së kanë pastruar 52,776,122 metra katrorë dhe kanë shkatërruar mbi 90,500 mina dhe mjete të tjera eksplozive. Nuk duhet të harrojmë faktin, që si pasojë e minave dhe mjeteve tjera shpërthyese në Kosovë, që nga koha e luftës e deri më sot kanë humbur jetën 117 persona si dhe 467 kanë pësuar lëndime të rënda fizike. FSK-ja mbetet e përkushtuar në pastrimin e çdo fushë nga minat dhe mjetet tjera shpërthyese", u shpreh zëvendësministri Çeku. Ndërsa, shefi i Qendrës Koordinuese për Deminim i Ministrisë së Mbrojtjes, z. Ahmet Sallova, e paraqiti Planin strategjik për eliminimin e minave dhe mjeteve tjera shpërthyese 2019-2024. „Kam kënaqësinë që në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit ndaj Minave ta prezantoj edhe Planin strategjik të veprimit ndaj minave dhe mjeteve tjera eksplozive për periudhën 2019-2024 në Kosovë. Andaj evitimi i rrezikut nga minat dhe mjetet tjera eksplozive është një parakusht për rindërtimin e vendit dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe ekonomike". Zoti Sallova falënderoi Ambasadën amerikane dhe SHBA-të, për përkrahjen e tyre të vazhdueshme gjatë operacioneve të pastrimit në Kosovë, si dhe për ofrimin e donacioneve dhe trajnimeve profesionale për Kompaninë e Deminimit të FSK-së. Ai gjithashtu falënderoi edhe Zvicrën, Norvegjinë, Holandën, Belgjikën dhe të gjitha vendet tjera që kanë ndihmuar vendin tonë në pastrimin e minave dhe mjeteve të tjera eksplozive. Ndërsa, Asa Massleberg nga Qendra Kombëtare për Deminim në Gjenevë, tha se procesi i planifikimit strategjik 2019-2024, mundëson lehtësimin e operacioneve që Kosova t'i përmbush objektivat e parapara në pastrimin e minave dhe mjeteve tjera shpërthyese.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

Vizita e liderëve të lartë të FSK-së dhe delegacionit të Shtabit të Forcës Tokësore në Ajova



Bazuar në Planin për bashkëpunim dypalësh me SHBA-të, dhe me qëllim të shkëmbimit të përvojave, në kuadër të aktiviteteve të Programit të Partneritetit me Gardën Kombëtare të Ajovës, dy delegacione të FSK-së, nga data 25–31 mars 2019, qëndruan për vizitë në Ajova. Në delegacionin e liderëve ishin komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu dhe rreshter majori i KDS-së, Xhevdet Mataj. Në të njëjtën kohë, në aktivitetin „Staff Directorate" në Ajova, ka qëndruar për vizitë edhe delegacioni i oficerëve të Komandës së Forcave Tokësore i përberë nga shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Hasan Hoxha, koloneli Fadil Hoxha, nënkolonel Arbnor Zeneli, majori Dedë Hiseni dhe kapiten Qëndrim Kastrati. Qëllimi i këtyre vizitave ishte shkëmbimi i përvojave mes liderëve dhe të stafit të FSK-së dhe të Gardës Kombëtare të Ajovës. Gjatë takimeve zyrtare u diskuan strategjitë e menaxhimit të trajnimeve dhe mekanizmat e planifikimit dhe prokurimit. Ky shkëmbim i përvojave do t'i ndihmojë stafit të KFT-së për të hartuar planin vjetor të trajnimeve, drejtimin dhe mbajtjen e gjendjes së trajnimeve individuale dhe atyre të njësive dhe hartimin e planit të trajnimeve për vitet e ardhshme. Në fokus të takimeve dhe vizitave ishte identifikimi i fushave të bashkëpunimit ndërmjet njësive dhe departamenteve homologe. Të dy delegacionet u pritën nga komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralmajor Timothy Orr, komandanti i Forcës Ajrore të Ajovës, gjeneral brigade Ford dhe stafi i Shtabit të Përbashkët të Gardës Kombëtare të Ajovës. Delegacionet kanë marrë pjesë në Brifingun e mirëseardhjes, kanë vizituar poligonet e operacioneve, Qendrën Simulative dhe Qendrën e Trajnimeve Specialistike ku u njoftuan me kapacitetet trajnuese që i ofrojnë këto qendra për FSK-në. Po ashtu delegacionet kanë vizituar Shtabin e Përbashkët të Forcave Ajrore ku janë informuar për vazhdimin e mbështetjes nga Garda e Ajovës në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së në mbrojtje kibernetike, mjekësi dhe MKAB. Delegacionet i kanë vizituar këto njësi dhe i kanë parë pajisjet dhe automjetet e tyre. Delegacioni i liderëve ka marrë pjesë në Këshillin e Menaxhimit të Seniorëve. Po të njëjtën ditë ata kanë vizituar Institutin Rajonal të Trajnimeve, ku janë informuar me trajnimet për zhvillim të liderëve dhe për trajnimet për specialitetet profesionale ushtarake të cilat i ofron ky Institut. Rreshter majori Xhevdet Mataj ka marrë pjesë në një punëtori me Rreshter majoren Fells të Gardës së Ajovës, rreth zhvillimit të kanalit të nënoficerëve. Delegacionet e FSK-së kanë marrë pjesë edhe në Këshillin e Gatishmërisë dhe Qëndrueshmërisë dhe kanë vizituar në kryeqytetin e Ajovës, Des Moins, Dhomën e Senatit të shtetit të Ajovës, ku janë pritur dhe informuar nga senatorët e Ajovës. Të dy delegacionet së bashku kanë vizituar Konsullatën e Republikës së Kosovës, ku janë pritur nga konsulli Xhavit Gashi, nga i cili janë informuar rreth bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Ajovës, në shumë fusha. Stafi i lartë i FSK-së, gjithashtu ka qenë i ftuar dhe ka marrë pjesë në Konferencën për oficerët e rinj, dhe në Takimin e Komandantit të Gardës së Ajovës me pjesëtarët e pensionuar të GKA (RECONCOM CALL). Kjo vizitë e oficerëve të FSK-së i paraprinë vizitës së stafit të lartë të Gardës Kombëtare të Ajovës e cila pritet të vizitojnë FSK-në, në muajin maj.

Shefi i Zyrës për Bashkëpunim dhe Mbrojtje i Ambasadës amerikane vizitoi Kompaninë e Deminimit



Kompaninë e Deminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) në Prizren e vizitoi shefi i Zyrës për Bashkëpunim dhe Mbrojtje i Ambasadës amerikane në Kosovë, major Brian Devlin së bashku me disa instruktorë të EUCOM-it. Mysafirët i priti komandanti i Kompanisë së Deminimit, majori Gëzim Sada, i cili pasi që i informoi mysafirët për kapacitetet operacionale të Kompanisë së Deminimit, i njoftoi edhe me të arritura e kësaj kompanie në pastrimin dhe eliminimin e mijëra mjeteve eksplozive në shumë fusha të minuara. Majori Devlin e përgëzoi komandantin Sada, për sukseset e Kompanisë së Deminimit, duke premtuar përkushtim dhe angazhim maksimal të tij dhe të shtetit amerikan për aftësimin profesional dhe pajisjen me mjete specialistike të Kompanisë së Deminimit, në ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ndërsa, instruktorët e EUCOM-it patën rastin që përgjatë tre ditëve të jenë së bashku me instruktorët e EOD-së, me të cilët biseduan për nevojat dhe planet e duhura për realizimin e trajnimit "Trajno Trajnerët - Niveli 2-të" , i cili pritet të mbahet gjatë muajit maj të këtij viti, me pjesëmarrje të pjesëtarëve të EOD-së nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe atyre të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ndihmuar dhe vazhdojnë ta ndihmojnë Kompaninë e Deminimit në ngritjen e kapaciteteve, si me pajisje specialistike moderne ashtu edhe me trajnime adekuate profesionale. Kompania e Deminimit, dje, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit ndaj Minave, ka filluar operacionet e pastrimit të fushave të rrezikshme me 4 ekipe në 4 lokacione të ndryshme. Andaj, edhe njëherë apelojnë te të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në rast që hasin në ndonjë mjet të dyshimtë, menjëherë të lajmërojnë FSK-në apo Policinë e Kosovës.

Forca e Sigurisë së Kosovës merr pjesë në Konferencën "Kosovo EOD Conference"

Me ftesë të shefit të Operacioneve të Ekipeve për Eliminimin e Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyera (EOD) të KFOR-it, Chiprian Andrica, Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht përfaqësuesit nga Kompania e Deminimit kanë marrë pjesë në konferencën "Kosovo EOD Conference", e cila është mbajtur në ambientet e kampit Bondstell. Në konferencë, përveç komandantit të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, major Gëzim Sada, morën pjesë edhe përfaqësues nga EOD-ja e KFOR-it dhe përfaqësuesit e organizatave „Halo Trust'', „NPA'' dhe „MAT Kosova'' që merren me deminim në territorin e Kosovës. Gjatë kësaj konference u prezantua puna e Kompanisë së Deminimit si dhe operacionet dhe trajnimet që zhvillohen në kuadër të aktiviteteve brenda FSK-së. Në punimet e konferencës u shpalos puna e ekipeve të deminimit nga të gjitha organizatat. Kjo konferencë ishte një mundësi e mirë e shkëmbimit të përvojave dhe krijimit të raporteve miqësore mes Kompanisë së Deminimit të FSK-së dhe organizatave tjera që merren me deminim në Kosovë. Konferenca u përmbyll me një marrëveshje bashkëpunimi në të ardhme, me qëllim të krijimit të një ambient të sigurt për të gjithë banorët e Kosovës.

Akademia Mbretërore „Sandhurst" i dhuron FSK-së literaturë ushtarake

Vazhdon realizimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës e në veçanti Akademisë Ushtarake Mbretërore „Sandhurst" dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje janë zhvilluar aktivitete në mbështetje të vazhdueshme të FSK-së nga Akademia Ushtarake Mbretërore „Sandhurst", për ngritjen arsimore dhe përgatitjen ushtarake të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët studiojnë në këtë akademi, që nga niveli bazik deri te niveli më i lartë. Akademia Ushtarake Mbretërore „Sandhurst", kësaj here i ka dhuruar një donacion me libra nga fusha ushtarake Qendrës për Studime Ushtarake të FSK-së. Këto do t'i ndihmojnë kadetët e QSU-së, të fitojnë njohuri të reja në fushën ushtarake. Librat e dhuruar nga Akademia Ushtarake Mbretërore „Sandhurst" janë bërë pjesë e literaturës së bibliotekës së kësaj qendre. Donacionin me libra ushtarake, komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiut, ia dorëzoi nënkoloneli anglez Jake White. Me këtë rast, gjeneral Spahiu ka falënderuar Akademinë Ushtarake Mbretërore „Sandhurst" për ketë donacion dhe për të gjitha ndihmat tjera. Gjeneral Spahiu tha se „Ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe do t'i forcojë lidhjet midis dy akademive ushtarake. Vlen për të theksuar se kapiteni Ismail Hoxha, i cili ishte kadet i QSU-së, do të fillojë turneun e tij dyvjeçar si instruktor në Akademinë Ushtarake Mbretërore „Sandhurst", që është një e arritur ushtarake dhe profesionale jo vetëm e Qendrës për Studime Universitare por edhe për vet FSK-në."

Shpallet ushtari më i mirë i FSK-së dhe i

Vijon nga faqja parë,

Në kazermën „Adem Jashari" në Prishtinë, solemnisht u shpallën rezultatet e Garës ndërkombëtare dhe të Garës së FSK-së „Ushtari më i mirë i vitit 2019". Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve ishin të pranishëm edhe zëvendësministri i Mbrojtjes Burim Ramadani, komandanti i Forcave Tokësore, njëherësh zëvendëskomandant i FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i BMO-së, gjeneral brigade Naim Haziri, zv. komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Mehmet Lladrovci, komandanti i RMC-së, kolonel Shaip Haziri dhe oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it si dhe oficerë e atashe të shteteve partnere të FSK-së. Me këtë rast, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Burim Ramadani, theksoi se që nga viti 2014 është krijuar tradita e kësaj gare, dhe që nga viti 2017 këtë garë e ka madhështuar edhe më shumë



pjesëmarrja e vendeve partnere. Orientimi dhe përkushtimi ynë si FSK, shtoi Ramadani, është të rrisim bashkëveprimin tonë me shtetet aleate të NATO-s. Kjo garë po tregon bashkëpunim dhe ndërveprim me pjesëmarrjen e 9 shteteve partnere në garë si: Shqipëria, Belgjika, Kanada, Kroacia, Maqedonia Veriore, Britania e Madhe, Polonia, Turqia, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë, promovon vlerat dhe shkëmbimin e përvojave dhe njëherësh ka krijuar miqësi në mes jush, prandaj besoj se këtë komunikim do ta vazhdoni edhe në të ardhmen. Komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, në fjalën e tij, theksoi se prezenca e 9 shteteve partnere në garë, më së miri e tregon vlerën dhe nivelin e garës. Kjo i jep kuptim të fuqishëm këtij organizimi u shpreh ai, duke i falënderuar në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, për organizimin dhe mbarëvajtjen e kësaj garës. Aktivitetet e realizuara e kanë bërë këtë garë mjaft sfiduese dhe interesante për pjesëmarrësit. Ne do të identifikojmë të arriturat, por edhe mangësitë ekzistuese, në mënyrë që në organizimet tjera kemi pjesëmarrje edhe më të madhe të vendeve partnere. Jemi të lumtur që ky vit është viti i parë me mandatin e ri të FSK-së dhe pjesëmarrja kaq e madhe të pjesëtarëve garues, si nga FSK-ja, po ashtu edhe nga partnerët tanë, na

Në Organizim të KFOR-it


U mbajtë ushtrimi fushor "Silver Sabre 2019-1"



Forca e Sigurisë së Kosovës ka marrë pjesë në ushtrimin vend-komandë "Silver Sabre 2019-1" të organizuar nga KFOR-i, i cili u mbajt nga data 24-25 prill 2019, (36 orë pa ndërprerje) në objektin e Kuvendit Komunal të Ferizajt. Për të përcjellë nga afër ushtrimin, në ditën e dytë, ishin të pranishëm krerët e lartë të FSK-së: zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajori Lorenco D'Addario, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale, gjeneral brigade Naim Haziri, zëvendëskomandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Mehmet Lladrovci, zëvendëskomandanti i KFOR-it, si dhe oficerë e nënoficerë të FSK-së, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, përfaqësues të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, përfaqësues të Policisë së Kosovës, si dhe pjesëmarrës të të gjitha institucioneve tjera emergjente. Me rastin e përfundimit të ushtrimit, në vend- komandë, të gjithë të pranishmit patën mundësinë të informohen në detaje për mbarëvajtjen e këtij ushtrimi përmes brifingjeve informuese, të cilat u realizuan nga përgjegjësit e këtij ushtrimi. Ndër arritjet më të mëdha konsiderohet bashkëpunimi dhe veprimi ndërmjet institucioneve në planifikimin, përgatitjen dhe ekzekutimin e operacioneve, si dhe vlerësimi i rreziqeve, si hap i rëndësishëm në ngritjen e profesionalizmit. Roli i FSK-së në ushtrimin vend-komandë „SILVER SABRE 2019-1" ishte angazhimi i trupave me qëllim të asistimit tw autoritetet qendrore në aplikimin e Planit të Reagimit Kombëtar, me anë të cilit përcaktohen reaguesit e parë, të dytë dhe të tretë. FSK-ja në këtë ushtrim ka marrë pjesë me 18 pjesëtarë, të cilët kanë qenë të përfshirë që nga faza përgatitore e deri në ekzekutimin e këtij ushtrimi, me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të bashkëpunimit dhe të koordinimit në nivel sa më të lartë me KFOR-in, si dhe ruajtjen e aftësive në standardin më të mirë të mundshëm.

Në Brigadën e Reagimit të Shpejtë certifikohen 60 ushtarakë të FSK-së

Në Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Istog, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve pjesëmarrës të trajnimeve: "Taktika me Njësi të Vogla" dhe "Trajnimi për Lidership". Për të përcjellë nga afër këtë ceremoni të pranishëm ishin edhe komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, përfaqësues të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) si edhe oficerë të tjerë të lartë të BRSH-së. Gjatë realizimit të kësaj ceremonie, përgjegjësi i trajnimeve toger Leotrim Hoti i njoftoi të pranishmit lidhur



me vështirësitë me të cilat janë përballur gjatë realizimit të trajnimeve, si dhe pikat kyçe në të cilat janë trajnuar studentët, si: patrullimet luftarake, marshimet, testimet fizike (përfshirë edhe testimin në ujë), planifikimin e urdhrave dhe zbatimin e tyre, luftërat urbane etj. Më pas, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj i përgëzoi instruktorët e trajnimit për punën dhe angazhimin e tyre në ngritjen dhe avancimin e pjesëtareve të FSK-së (përfshirë pjesëtarët e BRSH dhe të Brigadës për Mbështetje Operacionale), ndërsa të sapo certifikuarit i uroi për interesimin që ata treguan gjatë kësaj periudhe, duke theksuar se mënyra e duhur dhe profesionale e lidershipi është manifestimi i vlerave ushtarake përmes shembullit personal. Në fund të ceremonisë, u ndanë mirënjohje dhe certifikata për instruktorët e trajnimeve dhe për studentët pjesëmarrës. Për pjesëtarët e dalluar në trajnimin "Taktika me Njësi të Vogla 01-2019" u ndanë mirënjohje. Oficeri i Dalluar u shpall nëntogeri Defrim Kurti, Nënoficer i Dalluar-tetari Dardan Hasani, Ushtari i Dalluar-Besmir Shabani dhe çmimi Ushtari i Hekurt iu dha ushtarit Ergon Gashi. Në trajnimin "Taktika me Njësi të Vogla 01-2019", u certifikuan 46 pjesëtarë të BRSH-së dhe të Brigadës së Mbështetjes Operacionale, ndërsa në "Trajnimin për Lidership" u certifikuan 15 pjesëtarë.

garës ndërkombëtare për vitin 2019



jep vullnet se jemi në rrugë të drejt të krijimit të standardeve me partnerët tanë strategjikë. Ndërsa, rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj, tha se „gara ishte mjaft sfiduese, por nuk ishte vetëm garë. Këto ditë, ne së bashku kemi organizuar edhe vizita kulturore në vende të ndryshme në Kosovë, për t'i njoftuar partnerët me të kaluarën tonë. Jemi përgatitur së bashku edhe me partnerët për ecurinë e garës. Rreshter majori Metaj falënderoi të gjithë rreshter majorët që kanë organizuar dhe udhëhequr me sukses këtë garë. Ai, tregoi edhe historikun e garës, duke marrë si shembull në fillim, garën e ushtarit më të mirë të shtetit IOWA të SHBA-ve, dhe pastaj duke e përshtatur atë në një garë unike të FSK-së e që tash më është bërë tradicionale, sfiduese dhe shumë atraktive për garuesit. Në fund të ceremonisë u shpallën edhe rezultatet e të dyja garave. Ushtari më i mirë i vitit 2019, në nivel të FSK-së, u shpall tetari Besnik Nebihu, Brigada e Mbështetjes Operacionale, ndërsa vendi i dytë i takoi tetar Valon Hajdarit, Brigada e Reagimit të Shpejtë dhe vendin e tretë e zuri ushtari Shkodran Kokalla, Brigada e Reagimit të Shpejtë. Ndërsa fitues i garës ndërkombëtare "Ushtari më i mirë i vitit 2019" u shpall rreshteri Xhevat Maloku nga Republika e Shqipërisë, vendi i dytë i takoi tetarit Darko Dimitrijevic, nga Ushtria e Maqedonisë Veriore dhe vendi i tretë, tetarit Josif Agolli nga Ushtria e Republikës së Shqipërisë. Gara e ushtarit më të mirë e mbajtur në nivel të FSK-së, është zhvilluar nga data: 22-26 prill 2019, në kazermën „Skënderbeu" në Ferizaj, ku ushtarët dhe nënoficerët nga të gjitha njësitet e FSK-së dhe nga vendet partnere pjesëmarrëse garuan së bashku në këto disiplina: Test fizik, gjuajtje me armë, navigim tokësor, poligon me pengesa, hedhje e granatës, kalimi i zonës së rrezikshme, ndihma e parë, vëzhgimi i terrenit, dhe marshimi i shpejt me ngarkesë, me ç 'rast të gjithë garuesit treguan përkushtim dhe profesionalizëm të lartë gjatë tërë kohës së realizimit të këtyre garave. Në këtë garë morën pjesë 22 garues nga FSK-ja dhe 18 garues nga 9 vende partnere, si: Shqipëria, Belgjika, Kanadaja, Kroacia, Maqedonia Veriore, Britania e Madhe, Polonia, Turqia, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në shënimin e 20 vjetorit të Betejës së Kosharës

Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha mbajti fjalën tematike në manifestimin „Ditët e Shqipes" në Koshare

Me manifestimin qendror „Ditët e Shqipes" të mbajtur në Kompleksin Memorial të Betejës së Koshares dhe me homazhe te Varrezat e Dëshmorëve u shënua 20-vjetori i Betejës së Koshares. Manifestimi u zhvillua nën patronatin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. Në manifestim morën pjesë: presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, kryeparlamentari i Kosovës Kadri Veseli, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, zëvendësministri Agim Çeku, gjeneral majori Gëzim Hazrolli, në emër të komandantit të FSK-së, gjeneralë dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, deputetë dhe personalitete politike dhe shkencore, familjarë të dëshmorëve, invalidë, veteranë, bashkëluftëtarë, si dhe mijëra qytetarë nga të gjitha trojet etnike. Në fillim presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, bënë homazhe dhe vendosen kurora me lule pranë Varrezave të Dëshmorëve në shenjë respekti dhe kujtimi për veprën heroike të tyre. Në këtë manifestim, presidenti Hashim Thaçi, dekoroi me Urdhër të



Lirisë, Brigadën 138 „Agim Ramadani" dhe i shpalli të gjithë dëshmorët e kësaj brigade Heronj të Kosovës. Presidenti Thaçi, me këtë rast tha: "Beteja e Koshares ka hapur një kapitull të ri në atë kohë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës". Në fjalën e tij, kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli, tha: "U deshën 100 vjet që dëshmorët e lirisë t'i thonë jo ndarjes, pro bashkimit". Ndërsa, ministri i Ministrisë së Mbrojtjes, Rrustem Berisha, ish-komandant i Betejës së Koshares, manifestimin „Ditët e Shqipes" në 20-vjetorin e fillimit të Betejës së Koshares, e përshëndeti në emër të kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Ministri Berisha, tha se „vepra e dëshmorëve tashmë–Heronj, duhet të jetë udhërrëfyes për shtetin në ndërtim". Për Betejën e Koshares ai tha se „në këto shkrepa, në mëngjesin e 9 prillit 1999, borën e çanin vetëm ushtarët me uniformë të UÇK-së. Pas përgatitjeve të gjata dhe të përpikta ishin ushtarët e UÇK-së, që përfundimisht, me forcën e armës, e hoqën kufirin shqiptaro-shqiptar. Këta djem kishin zemër të madhe, kishin trimëri të pashoqe dhe betimin e dhënë për „liri a vdekje" e realizuan me Liri. Beteja e Koshares ishte një betejë e cila zgjati dhjetë javë, por ajo çka vlen të theksohet është se djemtë ishin vendosur të luftojnë deri në çlirimin e Kosovës". Ministri Berisha foli gjithashtu edhe për formimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe ushtrisë së Kosovës. „Jam krenar sot para jush e para gjithë kombit, për rrugën që kaluam nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, përmes Trupave Mbrojtëse të Kosovës e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për të arritur deri tek themelimi i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës. Si çdo shtet sovran, Kosova ka të drejtë të zhvillojë kapacitetet e veta mbrojtëse. Ky sovranitet është vërtetuar nga më se 100 shtete dhe është vulosur nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe nga kjo rrugë nuk ka kthim prapa. Prandaj, Ministria e Mbrojtjes, këtë vit, ka filluar ndërtimin e këtyre kapaciteteve, që do të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n, dhe me shtetet partnere, të cilat ishin përkrah nesh në luftën tonë çlirimtare. Në fund, ministri Berisha shtoi: "Punët e vështira janë për burrat me një mendje. Prandaj, ne nuk do të ndalemi, nuk do të rreshtim së ndërtuari amanetin e dëshmorëve, gurë mbi gurë". Në emër të familjeve të dëshmorëve, foli vëllai i Agim Ramadanit, Jashar Ramadani, i cili vlerësoi lart veprën dhe kontributin e të gjithë dëshmorëve të rënë në Koshare. „Kur këta trima që rrinë edhe këtu krah njeri tjetrit, dhe trimat që janë gjallë këtu, në mesin tonë, s'ka se si mos të thoshte Agimi: „Kur pushkët bashkohen edhe krismën e kanë më të fortë".

Ministri i Mbrojtjes priti përfaqësuesit e shoqatës „Atlantiku” nga SHBA



Ministri Rrustem Berisha ka pritur në Ministrinë e Mbrojtjes një grup anëtarësh të shoqatës shqiptaro-amerikane „Atlantiku”, njëherësh ish-luftëtarë të Batalionit „Atlantiku”të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, vullnetarë të ardhur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në luftën e Kosovës (1999). Ministri i Mbrojtjes z. Berisha, së pari iu dëshiroi mirëseardhje mysafirëve duke shprehur kënaqësinë e tij, që po pret në Ministri. Z. Berisha u shpreh: „Vendimi juaj për të ardhur në luftë, në ’99-tën, ishte një vendim shumë i qëlluar, që pati ndikim të drejtpërdrejtë në motivimin, jo vetëm të luftëtarëve që ishin nëpër vija të frontit, por edhe te popullata civile”. Më pas ministri Berisha i informoi veteranët e „Atlantikut” edhe lidhur me procesin e tranzicionit dhe planin e zhvillimit të FSK-së në të ardhmen. Në emër të komandantit të FSK-së, të pranishmit i përshëndeti gjeneral major Gëzim Hazrolli, i cili i falënderoi shqiptaro-amerikanët për kontributin e tyre gjatë kohës së luftës dhe për gjithë angazhimin dhe ndihmesën e tyre në ndërtimin e paqes. Vlen të përmendet ndihma e tyre ofruar për shkollimin e kuadrove të reja të Trupave Mbrojtëse të Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vazhdimësia e së cilës më pas u konkretizuar me planin dypalësh mes FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, si dhe bashkëpunimi me akademitë më prestigjioze amerikane siç është Akademia West Point. Ndërsa, në emër të shoqatës „Atlantiku” Mark Gjonaj e falënderoi ministrin Berisha për pritjen si dhe i përgëzoi krerët e FSK-së për arritjet në ndërtimin e Ushtrisë së Kosovës, si një prej institucioneve me vitale të shtetit, duke premtuar se shqiptaro–amerikanët, ish-luftëtarë të UÇK-së, përherë do jenë të gatshëm ta ndihmojnë Kosovën. Gjithashtu këtë takim e përshëndeten edhe Skënder Doqaj, ish-admiral shqiptar, Ukë Lushi dhe të tjerë. Në fund, veteranët e UÇK-së, pjesëtarë të shoqatës „Atlantiku”, vizituan kazermën e Forcave Tokësore dhe vendosën kurora me lule tek Obelisku i të rënëve.

Gjeneral majori Gëzim Hazrolli bën homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë



Gjeneral majori Gëzim Hazrolli, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, në emër të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramës, së bashku me oficerë të lartë të FSK-së, mori pjesë në shënimin e përvjetorit të 20-të Ditës së Dëshmorëve të Prishtinës. Në nderim të sakrificës sublime të dëshmorëve dhe heronjve, gjeneral Hazrolli vendosi lule të freskëta dhe bëri homazhe te Varrezat e Dëshmorëve dhe te Lapidari i heroit Zahir Pajaziti. Më pas gjeneral Hazrolli u takua edhe me familjarët e dëshmorëve, të cilëve u shprehu ngushëllime dhe krenari për veprën heroike të dëshmorëve në shërbim të lirisë së Kosovës.

Drejtori i Politikave të Mbrojtjes Faruk Geci mori pjesë në takimin e Kartës së Adriatikut A-5



Në kuadër të Kartës së Adriatikut- A5, më 19 prill, është mbajtur takimi i parë për vitin 2019, i nivelit të drejtorëve për politika të jashtme dhe të mbrojtjes, në kuadër të kryesimit të kartës nga Shqipëria. Nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës mori pjesë drejtori i Politikave të Mbrojtjes, z. Faruk Geci. Në këtë takim është diskutuar zbatimi i politikës së derës së hapur për anëtarësim në Kartën e Adriatikut dhe promovimi i politikës së derës së hapur për anëtarësim në NATO, kriza e emigrantëve, sfidat e sigurisë në Evropën juglindore, etj. Një nga temat kyçe, gjatë këtij takimi, ishte edhe anëtarësimi i Kosovës në Kartën e Adriatikut A5, ku mbështetje kanë shprehur pjesëmarrësit e të gjitha shteteve të rajonit, me kërkesën; që duhet të gjendet konsensusi për këtë çështje gjatë vitit 2019.

Nxënës dhe mësues nga diaspora vizitojnë Forcën e Sigurisë së Kosovës



Kazermën „Adem Jashari” në Prishtinë e vizituan rreth 100 nxënës nga diaspora të shoqëruar nga mësimdhënësit e tyre, të cilët jetojnë dhe veprojnë në Suedi dhe Austri. Vizitorët, gjatë dy orëve sa qëndruan në mjediset e FSK-së, patën mundësi që të njihen nga afër me jetën ushtarake të pjesëtarëve të saj. Një pritje e veçantë për nxënësit dhe mësuesit nga diaspora u organizua në amfiteatrin e Brigadës për Mbështetje Operacionale. Së pari, kapiten Nysret Buzhala bëri një prezantim për historikun, misionin, strukturën, kapacitetet dhe të arriturat e FSK-së. Më pas, nxënësit dhe mësuesit bënë pyetje të shumta, të cilave me profesionalizëm iu është përgjigjur kapiten Buzhala. Ndërkaq, për mysafirët u shfaq edhe një video - xhirim me përmbledhjen e ushtrimeve të ndryshme ushtarake dhe disa aktiviteteve të realizuara në FSK. Me këtë rast, mësuesi Faik Avdyli nga Ferizaj i cili jeton në Suedi u shpreh: „Jam mjaft i kënaqur nga pritja që na u bë sot, gjatë kësaj vizite. Dua t’ju përgëzoj për punën që bëni, për besimin që gëzoni në vendin tuaj dhe për të arriturat e FSK-së deri me tani”. Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit që ka Ministria e Mbrojtjes me Ministrinë e Diasporës. Pas përfundimit të vizitës, nxënësit dhe mësuesit nga diaspora drekuan së bashku me ushtarakët e FSK-së, në kuzhinën e kazermës në Prishtinë.

Kadetët e FSK-së

Gjenerata 2019 certifikohen në dy kurse



Në mjediset e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve të dy kurseve: kursi për Lider Luftarak dhe kursi për Procedurat Shtabore Komanduese. Në ceremoni ishin të pranishëm: komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu, zv. komandant kolonel Mehmet Lladrovci, zv. komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Hysen Dreshaj, komandantët e qendrave stërvitore, oficerë e nënoficerë të FSK-së, si dhe përfaqësues të NALT-i (Ekipi Këshillues–Ndërlidhës i NATO-s për FSK-në). Gjeneral brigade Irfete Spahiu, pasi përshëndeti pjesëmarrësit dhe kadetët, vuri theksin te roli dhe rëndësia e trajnimeve për ushtarakët e FSK-së, pa marrë parasysh nivelin dhe njësinë. Ndër të tjera gjeneral Spahiu u shpreh: „Të gjithë pjesëtarët e FSK-së duhet të jenë të përgatitur për detyra të reja, si në menaxhim, udhëheqje por edhe në disiplinë, pra këto janë vetëm disa nga vetitë që duhet t'i posedojë ushtaraku. Ju përgëzoj për një angazhim të tillë si dhe ju mirëpresim në trajnimet tjera avancuese në KDS". Po ashtu gjeneral Spahiu ju drejtua pjesëtarëve të Kursit të Liderit Luftarak, me fjalët se „ky Kurs ka për qëllim të ju përgatitë se si bëhet kalimi i përgjegjësive individuale në ato udhëheqëse dhe drejtuese në radhët e FSK-së". Ndërkaq, Kursi për Procedurat Shtabore Komanduese fokusohet në lidhje me zhvillimin e elementëve bazë që mundësojnë kalimin nga aftësitë dhe përgjegjësitë individuale në aftësi dhe përgjegjësi si staf në radhët e FSK-së. Kadetët gjatë kurseve ndoqën disa module trajnimi si: Modulin e Lidershipit dhe Modulin e Luftimit, ku zhvilluan shumë aktivitete si teorike ashtu edhe praktike, të cilat në fund kulmuan me një ushtrim fushor. Vlen të theksohet se këto ishin kurset e para për Gjeneratën e kadetëve 2019. Në Kursin për Lider Luftarak morën pjesë 44 pjesëtarë, nënoficerë të FSK-së, ndërsa në Kursin për Procedura Shtabore Komanduese morën pjesë 12 pjesëtarë, oficerë e nënoficerë të lartë të FSK-së.

Në Regjimentin e Mbrojtjes Civile

Certifikohen pjesëtarë të FSK-së për përdorim të pajisjeve detektuese

Në kazermën ,,Evropianët e rijnë'' të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Pomozatin, nga data 08-19 prill 2019, u zhvillua trajnimi për përdorimin e pajisjeve të reja detektuese të rrezeve Alfa, Beta dhe Gama, si dhe për përdorimin dhe ndërtimin e stacionit të dekontaminimit në masiv nga materiet e rrezikshme, mbajtur nga instruktorë të ekipit DITRA-të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 37 pjesëtarë, ku 4 prej tyre, përfaqësues të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me komandantin e Kompanisë së Kimisë, majorin Florenc Veliu. Me këtë rast, kompania e MKAB-së e FSK-së, ka përfituar njohuri të reja duke e rritur edhe më tutje nivelin operacional. Rendësi e veçantë e këtij trajnimi ishte edhe shkëmbimi i përvojave në mes të njësisë së kimistëve nga Republika e Shqipërisë dhe Kompanisë së MKAB-së nga Republika e Kosovës. Nga ky trajnim dolën rekomandimet e dy komandantëve, me të cilat u pajtuan



edhe ekipi i DITRA-së, që në të ardhmen të vazhdon bashkëpunimi i mëtutjeshëm në fushën e mbrojtjes nga materiet e rrezikshme dhe ndihma e ndërsjellë në rast nevoje. Me rastin e ceremonisë së certifikimit, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri falënderoi Ekipin e DITRA-së, për mbështetjen dhe kontributin e tyre në lidhje me pajisjet dhe trajnimin e pjesëtarëve të RMC-së, konkretisht të MKAB-së.

Pjesëtarë të FSK-së certifikohen në trajnimin „Mbijetesë në kushte vere"



Në kazermën „Evropianët e Rijnë" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Pomozatin, u mbajt ceremonia e certifikimit për pjesëtarët e FSK-së, të cilët përfunduan me sukses trajnimin: "Mbijetesë në kushte vere". Në këtë trajnim kanë marrë pjesë pjesëtarë nga të gjitha njësitet e FSK-së. Trajnimi ishte intensive dhe mjaft sfidues, por pjesëmarrësit me angazhimin e tyre arritën që ta përfundojnë me sukses. Trajnimi u realizua nga instruktorët e Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, dhe ishte i ndarë në dy pjesë: në pjesën teorike dhe praktike. Në trajnim u realizuan edhe këto tema: Psikologjia e mbijetesës; prioritetet në situata të mbijetesës; mënyrat për sigurimin dhe distilimin e ujit; ndërtimi i strehimoreve të ndryshme; sigurimi dhe përgatitja e ushqimit, testimi i bimëve për konsumim, orientimi në natyrë pa hartë dhe busull ditën dhe natën, ndihma e parë në mbijetesë etj. Në fund të ceremonisë, u ndanë certifikata dhe mirënjohje për pjesëmarrësit e trajnimit, të cilëve ua mundësojnë ndjekjen e nivelit të avancuar të këtij trajnimi, që pritet të realizohet gjatë këtij viti.

FSK-ja angazhohet në shuarjen e zjarreve në Komunën e Skenderajt dhe të Prishtinës

Në Kosovë, për shkak të thatësisë dhe temperaturave të larta që po mbretërojnë këto ditë, janë shpeshtuar ndezjet e pyjeve. Ekipet zjarrfikëse të FSK-së, janë angazhuar në mbështetje të pushtetit lokal për shuarjen e zjarreve në malet e Llaushës, Rakinicës dhe të fshatit Qubrel, Komuna e Skenderajt dhe në fshatin Vranidoll, Komuna e Prishtinës. Në këto operacione është angazhuar Njësia e Task Forcës e FSK-së, me 33 pjesëtarë dhe 7 automjete, të cilët kanë arritur t'i shuajnë zjarret në pjesën më të mëdha të pyjeve të këtyre anëve. Ndërkaq, operacioni për shuarjen e zjarreve ka vazhduar në fshatrat Llaushë, Qubrel dhe Vranidoll. Andaj, bëjmë apel te të gjithë qytetarët e Kosovës që të mos i ndezin mbeturinat dhe djerrinat sepse në këtë mot të thatë lehtë shkaktohen dëme në malet e Kosovës.

Në Komandën e Doktrinës dhe Stervitjes

Certifikohen 23 pjesëtarë të FSK–së në kursin "Udhëheqës i qitjes dhe mbikëqyrës i vijës së zjarrit"

Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj, u mbajte ceremonia e certifikimit të kursit "Udhëheqës i qitjes dhe mbikëqyrës i vijës së zjarrit". Në këtë ceremoni mori pjesë komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, e cila u shpreh mjaft e kënaqur me rezultatet e arritura dhe disiplinën që treguan pjesëtarët që ndoqën këtë kurs. Gjeneral Spahiu për këto të arritura u është mirënjohëse instruktorëve të Qendrës Bazike, të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm, gjatë këtyre tri javëve, treguan se janë të gatshëm në çdo kohë të përmbushin misionin dhe



detyrat e njësisë. Gjeneral Spahiu iu drejtuar kursantëve, duke kërkuar nga ta, që njohuritë e fituara në KDS t'i përcjellin në njësitë e tyre, ku ata shërbejnë, duke marrë përgjegjësi secili për të dhënë kontribut në proceset nëpër të cilat po kalon FSK-ja. Kursi „Udhëheqës i qitjes dhe mbikëqyrës i vijës së zjarrit" zgjati 3 javë dhe u ligjëruan këto tema: Menaxhimi i poligonit të qitjes, udhëheqja e qitjes, kalibrimi i armëve, qitja ditën dhe natën (teori dhe praktikë), zbatimi i rregullave të sigurisë etj. Kjo është gjenerata e parë për vitin 2019 e kursit "Udhëheqës i qitjes dhe mbikëqyrës i vijës së zjarrit", në të cilin morën pjesë 23 pjesëtarë të FSK-së, ku 5 prej tyre janë certifikuar si "Udhëheqës të qitjes dhe mbikëqyrës të vijës së zjarrit", ndërsa 18 të tjerë janë certifikuar si "Mbikëqyrës të vijë së zjarrit".

Në Qendrën e Kërkim-Shpëtim

Përfundoi trajnimi për shpëtim në ujëra të shpejta



Në kazermën "Evropianët e Rijnë" të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në Pomozatin, përfundoi trajnimi 5-ditor, për shpëtim në ujëra të shpejta, trajnim ky, që për here të parë është mbajtur nga instruktorët e FSK-së. Përmbajtja e kursit është zhvilluar dhe dizajnuar nga vetë instruktorët e QTKSH-së, bazuar në përvojat e fituara nga trajnimet e zhvilluara nga instruktorët e shteteve partnere të NATO-s. Për të rritur vlerën e trajnimit, instruktorët kanë zhvilluar kërkime të pavarura të teknikave dhe kombinimin e tyre me teknikat më bashkëkohore.

FSK-ja gjeti trupin e pajetë të një qytetari në Bjeshkët e Rugovës

Me vendim të ministrit të Mbrojtjes z. Rrustem Berisha dhe me urdhër të komandantit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, një ekipi i Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, u angazhua në operacionin e kërkimit, për gjetjen e një personi të zhdukur në Bjeshkët e Rugovës- Komuna e Pejës. Ekipi profesional i Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, prej 12 pjesëtarëve, pas një operacioni të gjerë kërkimi, në një terren të vështirë malor, ka arritur ta gjejë trupin e pajetë të personit të shpallur në kërkim nga Policia e Kosovës, me inicialet M.N. mosha 50 vjeçare, nga fshati Shtupeq i Madh i Pejës. Ekipi i FSK-së, trupin e pajetë e ka dorëzuar te Policia e Kosovës dhe familjarët e të ndjerit për procedura të mëtutjeshme.

Certifikohen 14 deminerë të rijnë të FSK-së

Kompania e Deminimit e FSK-së, me kapacitetet e saj, ka realizuar trajnimin bazik për 14 pjesëtarë të FSK-së, të cilët do t`u bashkohen ekipeve të deminimit në kryerjen e misionit për pastrimin, largimin dhe eliminimin e mjeteve të pashpërthyera në të gjithë territorin e Kosovës. Trajnimi është realizuara nga data 04 mars 2019 e deri më 12.04.2019, me fokus pastrimi i fushëbetejave dhe fushave të tjera të minuara. Në ceremoninë e mbajtur me rastin e përfundimit të trajnimit ishin të pranishëm komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile koloneli Shaip Haziri, këshilltari amerikan i NALT-it, nënkoloneli Todd Essing dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Kolonel Haziri deminerëve iu uroi punë të mbarë, siç u shpreh ai, në punën fisnike dhe me plot sfida në mbrojtje të jetës së qytetarëve të Kosovës, pa dallime. Ai kërkoi nga ta, që të kenë kujdes të shtuar gjatë punës së tyre, duke pas parasysh rrezikun me të cilin ballafaqohen çdo ditë. Ndërsa, nënkoloneli Essing i përgëzoi kursantët për suksesin duke iu uruar punë të mbarë dhe shëndet në detyrat e tyre të reja. Këta pjesëtarë u bashkohen radhëve të ekipeve të Kompanisë së Deminimit në terren për të vazhduar punën e palodhshme në eliminimin e të gjitha rreziqeve nga mjetet shpërthyese.



FORCA JONË

⋆⋆⋆ Viti VIII • Nr. 80 • 7 Qershor 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ⋆⋆⋆

Admirali James Foggo u prit me ceremoni ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes

Prishtinë, 22 maj - Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën sot në takime të ndara, në Ministrinë e Mbrojtjes, komandantin e Komandës së Bashkuar të Aleancës në Napoli, Admiralin James Foggo. Fillimisht, admirali amerikan Foggo i shoqëruar edhe nga komandanti i KFOR-it, gjeneral major Lorenzo D'Addario, u prit me ceremoni ushtarake nga Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama dhe oficerë të lartë të FSK-së. Më pas, u zhvillua takimi ndërmjet Ministrit të Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe admiralit amerikan Foggo. Takimi u fokusua në situatën e sigurisë në Kosovë e rajon, tranzicionin e FSK-së, bashkëpunimin dhe koordinimin me partnerët strategjikë si dhe qëllimin e palëkundur të Kosovës për anëtarësim në NATO dhe fokusimin në ndërtimin e kapaciteteve që garantojnë paqen në vend, rajon e më gjerë.



Ministri Berisha e njoftoi admiralin Foggo rreth procesit transparent të transicionit të FSK-së dhe koordinimin e vazhdueshëm me partnerët strategjikë. Ai i theksoi se „Në bashkëpunim me partnerët, kemi përgatitur Planin Gjithëpërfshirës Transitor. Zbatimi i këtij plani është gradual, gjatë 10 vjetëve të ardhshme, dhe ndahet në 3 faza. Ministria e Mbrojtjes është e përkushtuar që tranzicioni të bëhet në mënyrën e duhur dhe ky proces merr kohë. Janë përmbushur detyrat e fazës së parë A 120 + ditësh të Planit Gjithëpërfshirës Transitor sa i përket infrastrukturës ligjore dhe administrative''. Më tej, ministri i Mbrojtjes çmoi lart bashkëpunimin dhe koordinimin që kemi tash e 20 vjet me misionin e KFOR-it në Kosovë, të cilët kanë dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon, si ekipin e NALT-it për koordinimin dhe këshillimin e vazhdueshëm në çdo hap të ecjes tonë përpara.

Ministri Berisha përsëriti zotimin se FSK-ja edhe me mandatin e ri do të jetë forcë profesionale, multi-etnike dhe e besueshme, ku diversiteti është dhe do të mbetet vlerë, ku barazia është për të gjithë. Ministri shtoi se për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, qytetarët e Kosovës janë të gjithë të barabartë, pa marrë parasysh përkatësinë. FSK-ja për vite me radhë është institucioni që gëzon besimin më të lartë në Kosovë nga qytetarët', deklaroi Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha.

I pari i Ministrisë së Mbrojtjes në fund të takimit me admiralin amerikan, theksoi se Republika e Kosovës është përkushtuar për paqe, siguri, stabilitet dhe bashkëpunim me të gjithë. Kemi bashkëpunim të shkëlqyer me të gjitha vendet e rajonit që janë anëtare të NATO-s dhe ato që aspirojnë anëtarësim në NATO. Ne jemi të bindur se paqja e përhershme arrihet me anëtarësimin e secilit shtet të rajonit në NATO.

Nga ana e tij, komandanti i Komandës së Bashkuar të Aleancës në Napoli, admirali James Foggo, përgëzoi ministrin dhe komandantin për të arriturat e FSK-së dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me ekipin e NALT-it. Në veçanti shprehu admirimin e tij për profesionalizmin e lartë të pjesëtarëve të FSK-së. Ndër tjera, admirali e ka konsideruar sukses të jashtëzakonshëm të Kosovës pjesëmarrjen e FSK-së me dy kadetë në Akademinë Ushtarake Amerikane West Point si dhe angazhimet tjera në të mire të zhvillimit të gjithmbarshëm të institucionit dhe shoqërisë. Ndërsa, në takimin e komandantit të FSK-së, gjeneral Rama me Admiralin amerikan Foggo, u vlerësua lartë kontributi i NATO-s përmes KFOR-it dhe NALT-it në mbështetje të këshillimit dhe zhvillimit profesional të FSK-së.

Shefi i Mbrojtjes i Malit të Zi gjenerali Dragutin Dakiq vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes

Prishtinë, 27 maj - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti sot me ceremoni ushtarake shefin e shtabit të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, gjeneral brigade Dragutin Dakiq. Më pas gjenerali Dakiq u prit në takime të ndara nga ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Ministri Berisha e falënderoi gjeneralit Dakiq për angazhimin e Malit të Zi në KFOR dhe në Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në.



Më tej, Ministri i mbrojtjes u fokusua në bashkëpunimin rajonal dhe theksoi se duke pasur parasysh synimin tonë strategjik për anëtarësim në NATO, prioritet i yni është thellimi i bashkëpunimit më të gjitha vendet e rajonit që janë anëtare të NATO-s dhe ato që aspirojnë anëtarësim në NATO duke qenë të bindur se paqja e përhershme arrihet me anëtarësimin e secilit shtet të rajonit në NATO.

Gjenerali Dakiq falënderoi Ministrin Berisha dhe i përcolli gatishmërinë e ministrit të mbrojtjes së Malit të Zi për thellim të mëtejmë të bashkëpunimit. Të dy shefat e ushtrive gjenerallejtënant Rama dhe gjeneral Dakiq dhe delegacionet e dy forcave zhvilluan një takim të përbashkët ku u diskutua për marrëdhëniet e mira bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë si dhe për nevojën e zgjerimit dhe avancimit të këtyre marrëdhënieve në të ardhmen.

Në takimin me gazetarë, komandanti i FSK-së dhe shefi i Ushtrisë së Malit të Zi, u shprehën se Mali Zi dhe Kosova kanë marrëdhënie të mira në fushën e mbrojtjes dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndër të tjera, gjenerallejtënant Rama tha se synimi i Kosovës është anëtarësimi në NATO dhe integrimi në Bashkimin Evropian në përgjithësi, pra, Kosova synon të jetë pjesë e strukturave euroatlantike. Mali i Zi deri në anëtarësimin në NATO ka kaluar nëpër të njëjtën rrugë, prandaj çdo këshillë dhe përvojë nga Mali i Zi në këtë fazë të tranzicionit ka rëndësi të madhe për ne. Gjeneral Rama gjithashtu i ka ofruar edhe kapacitetet profesionale dhe specialistike të FSK-së si kontribut për bashkëpunimin bilateral dhe fqinjësor.

Shefi i Ushtrisë së Malit të Zi, tha se Mali i Zi promovon idenë e integrimit të Ballkanit perëndimor në strukturat Euro-Atlantike dhe se ky është i vetmi qëllim që garanton paqe dhe stabilitet në këtë rajon. Ai theksoi se, duke ditur qëllimin strategjik të Kosovës për anëtarësim në NATO, Mali i Zi është plotësisht i gatshëm që t'ju japë mbështetje juve dhe shteteve tjera fqinje, në realizimin e këtij qëllimi, si në nivel bilateral dhe multilateral.

Komandanti i FSK-së dekoroi me „Medalje për Shërbim Vetëmohues“ komandantin e Gardës së Ajovës

Prishtinë, 8 maj - Nën patronatin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Ministrinë e Mbrojtjes u organizua një pritje shtetërore për nder të komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës së SHBA-ve, gjeneral majorit Timothy Orr, ku morën pjesë përfaqësues institucionalë, deputetë, ministra, përfaqësues diplomatikë të akreditуar në Kosovë dhe ushtarakë. Me këtë rast, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama foli për rëndësinë e partneritetit ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës si dhe kontributin e gjeneralit Orr në këtë bashkëpunim.



„Që nga themelimi i Programit të Partneritetit Shtetëror në vitin 2011, në saje të vizionit strategjik dhe përkushtimit strategjik të gjeneralit Orr, FSK-ja është zhvilluar si forcë më profesionale dhe e gatshme për t'ju shërbyer qytetarëve të saj. Gjeneral Orr, unë jam shumë mirënjohës për përpjekjet e jashtëzakonshme të ushtarëve të aviacionit të Garda Kombëtare të Ajovës, që kanë bërë, nën udhëheqjen tuaj, për zhvillimin e zyrtarëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së.

Sot ne jemi më të fortë dhe më profesionalë, faleminderit Gjeneral”.

Në fund, gjeneral Rama e dekoroi gjeneralin amerikan Timothy Orr me Medaljen për Shërbim Vetëmohues. Ndërsa, gjenerali Orr i entuziazmuar nga atmosfera e ngrohtë, e krijuar për nderë të tij, deklaroi: „Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe jam shumë krenar që po nderohem me medalje nga FSK-ja. Ne, në veçanti kemi zgjedhur Kosovën nga 18 vende. Nga këtu po shoh anëtarët e forcave të mia dhe të FSK-së. E keni përkushtimin tim dhe do të vazhdojmë të ju ndihmojmë në këtë fushë”, tha ai.

FSK-ja pjesë e ushtrimit fushor ndërkombëtarë organizuar nga Ushtria Amerikane „Immediate Response -19“ në Kroaci dhe Hungari

Një kontingjent i FSK-së, po merr pjesë në ushtrimin fushor ndërkombëtar të organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR) së bashku me shtetet e NATO-s dhe me shtetet partnere, të quajtur „Immediate Response-19”. FSK-ja merr pjesë me 45 pjesëtarë të Batalionit të Tretë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë dhe Skuadrës së Deminimit (EOD). Në këtë ushtrim po marrin pjese rreth 1600 ushtarakë nga 15 shtete, të cilët po zhvillojnë operacione stërvitore në disa lokacione duke filluar nga Kroacia, Sllovenia dhe Hungaria.

Komandanti i FSK-së gjeneral Rama vizitoi ushtrimin „Immediate Response 19”



Kroaci, 29 maj - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të shefit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, gjeneral Mirko Shundov, po merr pjesë në ditën e vizitorëve të ushtrimit fushor ndërkombëtar të organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR), “Immediate Response 19” në Poligonin Ushtarak të Stërvitjes në Slunj të Kroacisë si dhe do të marrë pjesë edhe në shënimin e 10-vjetorit të anëtarësimit të Kroacisë në NATO. Gjeneral Rama në këtë aktivitet pati mundësi të shoh nga afër angazhimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës e përfaqësuar në ushtrim nga pjesëtarë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) dhe Ekipeve për Eliminimin e Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyera (EOD), të cilët krahas shteteve partnere dhe atyre të NATO-s treguan përkushtim dhe profesionalizëm të lartë në kryerjen e misioneve bazuar në skenarët e ushtrimit. Ky ushtrim mes tjerash, promovon stabilitetin dhe sigurinë në rajon por edhe forcon bashkëpunimin dhe rrit besimin në mes të partnerëve. Pjesëmarrja e FSK-së në këtë ushtrim kontribuon në avancimin e kapaciteteve të Forcës si në aspektin e organizimit, përgatitjes dhe të zbarkimit të njësiteve jashtë vendit, por edhe të operimit në mjedis shumëkombësh duke qenë të ndërveprueshëm në të gjitha aspektet e operimit. Në këtë ushtrim po marrin pjese rreth 1600 ushtarakë nga 15 shtete, të cilët po zhvillojnë operacione stërvitore në disa lokacione duke filluar nga Kroacia, Sllovenia dhe Hungaria. Ushtrimi do të realizohet prej datës 20 maj deri më datë 8 qershor 2019. Kontingjenti i FSK-së pjesëmarrës në këtë stërvitje ka shfaqur profesionalizëm dhe motivim të nivelit të lartë duke përfaqësuar denjësisht FSK-n gjatë tërë stërvitjes, si dhe duke qenë të barabartë me ushtritë partnere dhe ato te vendeve të NATO-s.

Komandanti i KFOR-it ligjëroi para kadetëve të FSK-së

Prishtinë, 6 maj - Qendra për Studime Universitare, 6 maj-Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Lorenzo D’addario, mbajti ligjëratë para kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së. Në këtë ligjëratë ishin të pranishëm edhe shefi i Shtabit i Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Hasan Hoxha, komandanti i Qendrës për Studime Universitare, major Vegim Krelani, si dhe oficerë, nënoficerë dhe kadetë të FSK-së. Në fillim, komandanti i Qendrës për Studime Universitare, major Vegim Krelani, për gjeneralmajor D`Addario mbajti një prezantim të shkurtër informues lidhur me misionin, detyrat dhe punën e QSU-së. Ndërkaq, gjeneral major Lorenzo D’addario ligjëroi dhe shtjelloi disa tema të rëndësishme, ku kryesisht shpalosi përvojën e tij personale gjatë ngritjes në karrierë, sidomos përvojën e fituar gjatë misioneve dhe angazhimeve të tij në kuadër të NATO-s, si organizatë shumëkombëshe. Pas përfundimit të ligjëratës, kadetët patën mundësi të shtrojnë pyetje të ndryshme rreth temave që shtjellojë gjeneral majori D`Addario. Komandanti i KFOR-it bëri edhe një foto të përbashkët me të gjithë kadetët dhe stafin e QSU-së, të cilët i përgëzoi për punën dhe përkushtimin e tyre.



FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma “Adem Jashari”, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Zëvendësministri Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama pritën gjeneralin Orr

Gjenerali Orr, portret i mbështetjes amerikane për FSK-në



Prishtinë, 6 maj - Sot në Ministrinë e Mbrojtjes, zëvendësministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën në takime të ndara gjeneralmajorin Timothy Orr, komandant i Gardës Kombëtare të Ajovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në takimin e zv. ministrit Ramadani me gjeneralin Orr u diskutua për arritjet e Kosovës në themelimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe mandatin ushtarak të FSK-së, po ashtu për planet e Ministrisë së Mbrojtjes për periudhën e ardhshme në zhvillimin dhe modernizimin e FSK-së. Gjenerali Orr u njoftua për zhvillimet e përgjithshme në Kosovë, për gatishmërinë e Kosovës për të dhënë kontribut për sigurinë kudo në botë krah përkrah me trupat amerikane dhe të NATO-s. Kosova është plotësisht e përkushtuar në thellimin e marrëdhënieve të përjetshme më SHBA-të në të gjitha fushat, duke marrë shembull marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes.

Komandanti i Gardës së Ajovës ndan medalje për komandantin e FSK-së

Prishtinë, 8 maj - Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, në një ceremoni rasti, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneral majori Timothy Orr dekoroi me Medalje për Shërbim të Shquar, komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Medalja amerikane për komandantin e Ushtrisë së Kosovës ka këtë motivacion: ,,Për performancë të shkëlqyeshme në Programin e Partneritetit Shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Ajovës. Që nga marrja e detyrës gjenerallejtënant Rrahman Rama punoi pa u lodhur për të avancuar marrëdhëniet strategjike të Gardës Kombëtare të Ajovës me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Shtetit të Ajovës me Republikën e Kosovës. Përkushtimi i tij dhe mbështetja e palëkundshme e Programit të Partneritetit Shtetëror dhe veçanërisht Gardës Kombëtare të Ajovës janë në përputhje me nivelin më të lartë të shërbimit ushtarak. Veprimet dhe angazhimi i gjenerallejtënant Rrahman Ramës pasqyrojnë



një kredi të madhe ndaj tij, Gardës Kombëtare të Ajovës, Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës''. Gjithashtu, gjeneral Orr ka dekoruar me Medalje për Shërbim të Shquar edhe rreshter majorin e parë të FSK-së Genc Metaj, për kontributin e tij, në zhvillimin dhe profesionalizimin e Trupës së nënoficerëve si dhe zhvillimin dhe avancimin e marrëdhënieve në këtë nivel me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Në Ambasadën e Shqipërisë në Prishtinë

Ministri i Mbrojtjes Berisha homazhe në përkujtim të dy ushtarakëve të rënë gjatë misionit të paqes në Letoni



Prishtinë, 13 maj - Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, z. Rrustem Berisha, sot vizitoi Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Prishtinë, për të bërë homazhe me rastin e rënies në krye të detyrës të Major Klodian Tanushit dhe ushtarakes Nëntetare Zarife Hasanaj, gjatë misionit të NATO-s në Letoni. Pas homazheve ministri Berisha u nënshkrua në Librin e Zisë.

Ministri Berisha u prit nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Prishtinë, z. Qemal Minxhozi, të cilit në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe të Ushtrisë së Kosovës i shprehu ngushëllimet më të thella për humbjen e jetës së dy oficerëve të Shqipërisë, gjatë kryerjes së misionit të tyre në Letoni, dhe përmes tij edhe ministres së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, znj. Olta Xhaçka dhe familjarëve të tyre.

Në Librin e Zisë, ministri Rrustem Berisha, shkroi: „Major Klodian Tanushi dhe Nëntetarja Zarife Hasanaj, si dëshmorë të paqes dhe sigurisë, na treguan të gjithëve se edhe mbrojtja e paqes kalon nëpër sakrifica dhe përballje me rrezikun për përmbushjen e detyrave ushtarake. Lavdi e përjetshme për dëshmorët më të rijnë të kombit shqiptar, Heronjtë e Paqes Major Klodian Tanushi dhe Nëntetare Zarife Hasanaj“. Ministri Berisha në fund u shpreh se: „edhe populli shqiptar po kontribuon për paqe dhe siguri, ashtu siç kanë kontribuar të tjerët për lirinë e Kosovës. Edhe FSK-ja në të ardhmen do të jetë e gatshme që mos të jetë vetëm konsumues i sigurisë, por edhe kontribuues aktiv i saj. Edhe njëherë u shprehu ngushëllime familjeve, institucioneve dhe gjithë popullit shqiptar”.

Zëvendësministri Ramadani priti në takim komandantin e KFOR-it gjeneralin D'Addario



Prishtinë, 20 maj - Sot në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, zv. ministri Burim Ramadani së bashku me gjeneral majorin Gëzim Hazrolli, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Mbrojtjes, kanë pritur në një takim zyrtar komandantin e KFOR-it, gjeneralin Lorenzo D'Addario me bashkëpunëtorë.

Zv. ministri Ramadani, gjatë takimit me komandantin e KFOR-it, gjeneralin D'Addario, theksoi se: „Kosova ka synim shtetëror anëtarësimin në NATO dhe e kupton rrugën në këtë proces. Duke qëndruar në planifikimet afatgjata dhe graduale për zhvillimin dhe modernizimin e sektorit të sigurisë sipas standardeve demokratike, institucionet e Kosovës janë të përkushtuara në transparencë, bashkëpunim dhe angazhim me partnerët ndërkombëtarë“. Gjithashtu, z. Ramadani, nder të tjera, shtoi se „ne jemi të kënaqur me bashkëpunimin dhe koordinimin që kemi tash e 20 vjet me misionin e KFOR-it në Kosovë. Kosova është e përkushtuar për paqe, siguri, stabilitet dhe bashkëpunim me të gjithë“,- u shpreh në fund, z. Ramadani.

Në Ministrinë e Mbrojtjes-Mbahet konferenca dyditore „FSK dhe PARTNERËT 2019-I“

Ministri Berisha: Të arriturat e FSK-së janë suksese të përbashkëta të Kosovës dhe aleatëve perëndimorë



PRISHTINË, 16 MAJ - Ministria e Mbrojtjes, 16 maj- Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, për herë të parë pas miratimit të ligjeve për Ministrinë dhe FSK-në, filloi punimet konferenca dyditore „FSK dhe Partnerët 2019-I'' me pjesëmarrje të atasheve të Mbrojtës të shteteve partnere, KFOR-it dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë e Mbrojtjes (MM) dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (NALT/MM/FSK). Në hapjen e punimeve të konferencës morën pjesë ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, zv.ministrat Burim Ramadani dhe Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe plane Faruk Geci, komandanti i KFOR-it gjeneral majori Lorenzo D'Adario, drejtori i NALT-it, gjenerali Uwe Becker, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së, KFOR-it dhe NALT-it, si dhe atashe të FSK-së.

Në fjalën e tij hyrëse, ministri Berisha, duke ju shprehu falënderime të gjithë atasheve ushtarakë dhe atyre të Mbrojtjes të shteteve të rajonit, shteteve partnere, shteteve të NATO-s si dhe të gjithë të ftuarve të tjerë, tha: „Falënderoj shtetet partnere në krye me SHBA-në, NATO-n për mbështetjen e vazhdueshme që na e kanë dhënë dhe po vazhdojnë të na japin në zhvillimin e FSK-së. Të gjitha të arriturat e FSK-së janë suksese të përbashkëta dhe kjo historia suksesi është e Kosovës dhe aleatëve perëndimorë. FSK-ja edhe me mandatin e ri do të jetë forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme, ku diversiteti është dhe do të mbetet vlerë, ku barazia është për të gjithë. Për MM dhe FSK-në, qytetarët e Kosovës janë të gjithë të barabartë. MM dhe FSK-ja bashkëpunon me këshilltarët e NALT-it në baza ditore. Me këtë rast dëshiroj t'i falënderoj për ndihmën këshilluese dhe përkrahjen e vazhdueshme që po na japin në zhvillimin e FSK-së. Ne jemi të kënaqur me bashkëpunimin dhe bashkërendimin që kemi tash e 20 vjet me misionin e KFOR-it në Kosovë, të cilëve dua t'u falënderohem për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon. Republika e Kosovës është përkushtuar për paqe, siguri, stabilitet dhe bashkëpunim me të gjithë. Ne jemi të bindur se paqja e përhershme arrihet me anëtarësimin e secilit shtet të rajonit në NATO'',- përfundoi fjalën e tij ministri Berisha. Gjithashtu edhe gjenerallejtënant Rrahman Rama mbajti një fjalë rasti, ku ndër të tjera tha:

„Më lejoni që në emër timin dhe në emër të ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës të ju falënderoj për kontributin e vazhdueshëm dhe të jashtëzakonshëm që po ofroni për të ngritur aftësitë dhe kapacitetet tona kombëtare. Ne kemi avancuar dukshëm në ngritjen e kapaciteteve duke arritur ndërveprueshmëri me partnerët tanë. Këtë më së miri e kemi dëshmuar në ushtrimin fushor "Shqiponja 6", si dhe në pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrimet në nivel ndërkombëtar. FSK-ja ka nevojë për mbështetjen tuaj në rrugëtimin tonë të përbashkët për të qenë të gatshëm që t'ju mbështesim në të ardhmen atëherë kur të kërkohet. Ju partnerë të FSK-së, keni një rol të rëndësishëm në zhvillimin e FSK-së si forcë ushtarake e besueshme dhe gjithëpërfshirëse",- u shpreh gjeneral Rama.

Gjatë seancës së parë folën edhe komandanti i KFOR-it, gjeneral majori Lorenzo D'Addario dhe drejtori i NALT-it gjeneral brigade Uwe Becker, ndërsa më pas koloneli Agron Bajrami, drejtor i Departamenti për Siguri dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Vlen të përmendet se në punimet e konferencës së parë për vitin 2019 „FSK dhe Partnerët'' po marrin pjesë atashe të Mbrojtjes nga Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Kroacia, Turqia, Maqedonia, Mali i Zi, Gjermania, Italia, Hungaria etj. Konferenca do t'i vazhdojë punimet edhe nesër me prezantimin e nevojave dhe projekteve të disa prej fushave me interes të veçantë për zhvillimin e Forcë në këtë fazë.



Forcës së Sigurisë të Kosovës i shtohen edhe dy pilotë



Turqi, 31 maj 2019- Ushtrisë së Kosovës po i shtohen radhët me kuadro të reja oficerësh, profilesh të ndryshme, për të qenë forcë profesionale dhe e ndërveprueshme me ushtritë tjera mbi bazën e standardeve të NATO-s. Në vazhdën e suksesseve të arsimimit dhe profesionalizimit janë edhe dy oficerë të rinj, pilotët e Ushtrisë së Kosovës, nëntoger Atdhe Hasani dhe nëntoger Krenar Voca, të cilët përfunduan me rezultate të shkëlqyera shkollimin profesional për pilot helikopteri në Akademinë Ushtarake "Kara Havacilik Okulu" në Republikën e Turqisë. Nëntoger Atdhe Hasani, me suksesin e treguar gjatë shkollimit të tij, ka arritur që të radhitet i dyti në mesin e kadetëve më të mirë të gjeneratës. Në ceremoninë e diplomimit i pranishëm ishte atasheu i FSK-së i akredituar në Turqi, kolonel Bekim Osmani. Oficerët e rinj, të cilët kanë përfunduar me sukses akademinë ushtarake për pilot, pritet që së shpejti, pas kthimit nga Turqia, të angazhohen me shërbim aktiv në Forcën e Sigurisë së Kosovës, për të dhënë kontribut në ngritjen e kapaciteteve ushtarake në lëmin e aviacionit. Në bazë të marrëveshjes dypalëshe, Republika e Turqisë po vazhdon të ndihmojë në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja të FSK-së.

Tetari Liridon Selimi fitoi vendin e dytë në Garën Ushtarake Ndërkombëtare në Kroaci



Kroaci, 13 maj - Në mesin e pjesëmarrësve nga 13 shtete të Botës, garues të Garës Ushtarake Ndërkombëtare në Republikën e Kroacisë, ushtaraku i Forcës së Sigurisë të Kosovës, tetar Liridon Selimi (Kompania e Operacioneve Civile) zuri vendin e dytë, duke u renditur pas ushtarakut rumun rreshter Mera Dorel Silviu si dhe duke lënë pas ushtarin amerikan William Hennesy.

Konkursi i këtij viti është organizuar nga Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës „Fran Krsto Frankopan" të Ushtrisë Tokësore kroate. Konkurrentët dhe pretendentët nga tri kategori, një total prej 146 ushtarakësh, kanë zotëruar gjatësinë e përcaktuar të garës prej 40 kilometrave, në kazermën „Josip Joviç“ si dhe fushën e Krbava-s.

Gara u zhvillua në fazën kualifikuese, pra gjuajtja kualifikuese me armë, që u mbajt më 9 maj 2019 si dhe gara kryesore ku sipas planit duhej të kalohej distanca prej 40 kilometrash, më 12 staci-one punuese dhe 8 pika kontrolli. Stacionet punuese në të cilat u sfiduan ushtarakët garues ishin: navigimi, hedhja e granatës, poligoni i kalitjes, gjuajtje me VHS D2 (automatik), gjuajtje me HS-9 (pistoletë), gjetja e lokacionit në hartë, identifikimi dhe kontrolli i personit, ndihma e parë në fushëbetejë, gjuajtja me AT-4 (antitank), kalimi i zonave të minuara dhe kontaminuara, kalimi i lumit mbi litarë dhe thirrje për zjarr indirekt. Kosova, përkatësisht ushtria e saj, në Garën Ushtarake Ndërkombëtare në Republikën e Kroacisë u përfaqësua nga dy ushtarakë të rinj, rreshter Lorik Ramaj dhe tetar Liridon Selimi, ku ky i fundit tregoi sukses të madh në garë duke fituar vendin e dytë.

Në Universitetin Amerikan diplomojnë 11 kadetë të FSK-së- niveli Bachelor



Prishtinë, 17 maj - Dje në mjediset e Universitetit Amerikan të Kosovës (AUK) u mbajt ceremonia e diplomimit në nivelin Bachelor të studentëve të këtij universiteti. Në emër të FSK-së, në ceremoni morën pjesë komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, komandanti i Qendrës për Studime Universitare, major Vegim Krelani si dhe stafi komandues i QSU-së. Ceremonia u hap nga kadetët e FSK-së, të cilët performuan drillin me flamuj në nderim të himneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në ceremoninë e 15-të të diplomimit të kadetëve të FSK-së, në Universitetin Amerikan në Kosovë, diplomuan 11 kadetë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, prej të cilëve 8 kadetë i takonin vitit të IV-të “Gjenerata 2019”, ndërsa 3 kadetë i takonin vitit III-të „Gjenerata 2020”, të cilët arritën që me sukses t’i përfundojnë provimet një vit më herët. Kadeti Dritëro Bajrami është përzgjedhur studenti më i dalluar i gjeneratës 2019, për arritje të larta akademike në mesin e kolegëve të tij. Po ashtu, Dritero Bajrami është kadeti i parë që mori titullin Student i Shoqërisë së Nderit „Salutatorian” në RIT Kosovë (AUK). Kadeti Bajrami njëherësh ishte edhe folësi kryesor në ceremoni, i cili fjalimin e tij e përmbylli me fjalinë „tri gjerat që na kanë sjellë deri këtu ku jemi sot, do të na prijnë në shekujt e ardhshëm, dhe ato janë Detyra, Nderi dhe Atdheu.” Në fund, stafi komandues i QSU-së u takua edhe me familjarët e kadetëve, të cilët i uruan për arritjet akademike dhe diplomimin me sukses të bijve të tyre në programin civil të studimeve.

Komandanti i FSK-së priti një delegacion të oficerëve ushtarakë nga Turqia

Prishtinë, 13 maj - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti një delegacion oficerësh të lartë ushtarakë nga Turqia, në krye me gjeneral brigade Umut Yildiz, të cilët po qëndrojnë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në FSK për të marrë pjesë në Takimin Vjetor të Dialogut Ushtarak që po zhvillohet mes ushtarakëve, përfaqësues të MM-së dhe FSK-së, si dhe delegacionit nga Turqia. Në takimin e përbashkët të gjeneralëve



Rama dhe Yildiz u bisedua për marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Turqisë, shkëmbimet dhe aktivitetet shkollore, trajnuese dhe ato të stërvitjeve, të cilat janë duke u zhvilluar në kuadër të marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë.

Në fund, të dy gjeneralët shprehën gatishmërinë për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit si dhe angazhim edhe më të madh në identifikimin e aktiviteteve dhe zgjerimin e fushave të bashkëpunimit sipas marrëveshjes.

Komuniteti arbëresh nga Sicilia viziton Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ushtrinë



Prishtinë, 3 maj - Zëvendësministri i Mbrojtjes Burim Ramadani dhe gjeneral major Gëzim Hazrolli, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, pritën sot në vizitë ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi së bashku me një delegacion të komunitetit arbëresh nga Sicilia e Italisë. Zv. ministri Ramadani së pari i dëshiroi mirëseardhje delegacionit arbëresh, duke shprehur konsideratën e tij të lartë, jo vetëm për përkushtimin e këtij komuniteti në ruajtjen e kulturës dhe gjuhës shqipe, por edhe për kontributin e tyre të madh brez pas brezi, duke çmuar në veçanti kontributin e pinjollëve të këtij komuniteti në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Më tej, zëvendësministri Ramadani tha se; „Republika e Kosovës ka për objektiv kryesor integrimin në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin në NATO. Kosova ka orientim perëndimor, ashtu siç është edhe partneri ynë, shteti i Italisë, pra shteti juaj ku ju jetoni dhe kontribuoni, anëtar i NATO-s dhe i bashkimit Evropian", u shpreh ndër të tjera zv. ministri Ramadani.

Më pas, delegacioni arbëresh vazhdoi vizitën e tij në Komandën e Forcave Tokësore, duke u pritur përzemërsisht në të gjitha repartet e saj. Vizita e arbëreshëve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Ushtri u zhvillua në kuadër të aktivitetit „Ditët e Arbëreshëve" në Kosovë, të organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, nën patronazhin e kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj.

Drejtori për Politikat e Mbrojtjes Faruk Geci mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar në Paris

Francë, 13 maj - Sesioni i parë i Seminarit Ndërkombëtar për Ballkanin, që u mbajt në Shkollën Ushtarake në Paris, u organizua nga Instituti i Studimeve të Larta të Mbrojtjes Kombëtare (IHEDN), nën patronazhin e kryeministrit të Francës. Seminari është i pari i këtij lloji dhe ka të bëjë me ri-angazhimin e Francës në Ballkan.

Në këtë seminar, Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës e përfaqësoi drejtori i Drejtorisë për Politikat e Mbrojtjes Faruk Geci. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin përfaqësuesit e të gjitha shteteve të rajonit, profesionistë civilë të administratës shtetërore, ushtarakë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Temat që u diskutuan në Seminar kryesisht kishin të bënin me diplomacinë franceze në Ballkan, dinamikën e pajtimit, krimin e organizuar si sfidë për sundimin e ligjit, radikalizmin, dinamikat trans-kufitare, sigurinë kibernetike, integrimin euroatlantik, aktorët kryesorë ndërkombëtarë në Ballkan, kontributin e Ballkanit në sigurinë dhe paqen e Evropës etj.

Gjenerali Enver Cikaqi priti shefin e Seksionit për Operacione në Komandën e Ushtrisë së Suedisë nënkolonelin Mattias Brehag



Prishtinë, 22 maj - Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Hasan Hoxha dhe shefi i Sektorit për Bashkëpunim Bilateral dhe Multilateral në Ministrinë e Mbrojtjes nënkolonel Sefer Shyti, priti sot në takim shefin e Sektorit për Operacione në Komandën e Ushtrisë së Suedisë nënkolonelin Mattias Brehag, i cili shoqërohej edhe nga major Anders Berg-oficer i logjistikës dhe këshilltar i NALT-it nga Suedia, nënkoloneli Hans Rehnberg. Gjatë takimit, gjenerali Enver Cikaqi e njoftoi nënkolonelin Brehag për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, procesin e tranzicionit, shkollimet, trajnimet, bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar etj.

Në takim u bisedua për mundësitë tjera të bashkëpunimit dypalësh në mes dy shteteve, për fushat e bashkëpunimit dhe të mbështetjes në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore e teknike. Me këtë rast, gjeneral Cikaqi e falënderoi nënkolonelin Brehag edhe për bashkëpunimin dhe kontributin e ushtrisë dhe shtetit suedez në zhvillimin e FSK-së. Të dy palët shprehën gatishmëri për ngritjen dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen, si dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

QSU-ja pjesë e Simpoziumit Ndërkombëtar të Akademive Ushtarake në Stokholm

Suedi, 24 maj - Një delegacion nga Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë të Kosovës, i prirë nga komandanti i Qendrës për Studime Universitare, major Vegim Krelani, i shoqëruar nga kapiten Krenar Lahu dhe kadet Arbenita Haxholli, mori pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar të Akademive Ushtarake në Stokholm të Suedisë. Temë e këtij simpoziumi ishte „Menaxhimi i Përshtatjes në Arsimimin dhe Trajnimin Ushtarak", ku akademitë nga vendet e ndryshme të botës prezantuan punimet e tyre lidhur me këtë temë.

Kadet-ja Arbenita Haxholli nga Qendra për Studime Universitare, prezantoi punimin e saj me temë "Oficerët e rinj dhe tradita: një konflikt i pashmangshëm", i cili u mirëprit dhe u vlerësua jashtë-zakonisht lart nga pjesëmarrësit e këtij simpoziumi. Pjesëmarrja në këtë simpozium i krijoi mundësi të mira delegacionit të QSU-së që të zhvillojë takime dypalëshe me akademi të ndryshme nga shtete si Koreja e Jugut, SHBA-të, Kanadaja, Suedia, Danimarka, Norvegjia etj. Ideja e këtyre takimeve ishte inicimi i mënyrave të bashkëpunimit. Në përfundim të këtij simpoziumi, Shoqata Ndërkombëtare e Akademive Ushtarake (IAMA) i bëri ftesë zyrtare Qendrës për Studime Universitare që të bëhet anëtare e kësaj shoqate. Kjo shoqatë ka pesë objektiva kryesorë: të ndajë njohuritë dhe praktikat më të mira në mes akademive; të lehtësojë shkëmbimin e kadetëve mes akademive të ndryshme; të organizojë dhe të mirëpresë aktivitetet; të zgjerojë rrjetin e akademive ushtarake dhe të formojë grupe teknike për të trajtuar çështjet që kanë të bëjnë më edukimin e oficerëve të rijnë. Simpoziumi organizohet nën ombrellën e Shoqatës Ndërkombëtare të Akademive Ushtarake (IAMA). Këtë vit, simpoziumi është organizuar dhe mirëpritur nga Akademia Ushtarake Karlberg në Stokholm, nga data 20 deri më 23 maj 2019. Në këtë simpozium morën pjesë akademitë ushtarake më prestigjioze nga 20 vende të ndryshme të botës

Delegacioni i kadetëve i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë vizitoi FSK-në

Prishtinë, 31 maj - Në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), gjatë këtyre dy ditëve, ka qëndruar për vizitë një delegacion i kadetëve të FARSH-së së bashku me pedagogët e stafit akademik të Kursit për Përgatitjen e Oficerit, me një përbërje prej 60 pjesëtarësh. Gjatë vizitës, pjesëtarët e delegacionit vizituan Qendrën për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë dhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, ku zhvilluan takime të ndryshme me pjesëtarët e FSK-së, të cilën përmes disa prezantimeve i njoftuan me ecurinë e përgatitjes së oficerëve të rinj të QSU-së. Stafi akademik i FARSH-së, i kryesuar nga shefi i Departamentit të KPO –së kolonel Zaho Golemi, u priti edhe nga komandanti i Komandës së Forcave



Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Hasan Hoxha dhe komandantin e Qendrës për Studime Universitare, major Vegim Krelani.

Ata së bashku diskutuan për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy ushtrive, si dhe për mënyrën dhe rëndësinë e shkollimit të kadetëve. Më pas, stafi i pedagogëve të FARSH-së iu bashkua kadetëve të FSK-së dhe FARSH-së, të cilët po shoqëroheshin me njëritjetrin dhe po shkëmbenin përvoja së bashku. Ndërkaq, gjeneral Cikaqi i përshëndeti dhe i përgëzoi kadetët për sukseset e treguara gjatë shkollimit dhe për miqësinë që ata krijuan gjatë këtyre ditëve, duke kërkuar nga ta që kontaktet e krijuara gjatë kësaj vizite t'i ruajnë dhe t'i avancojnë në të ardhmen duke shkëmbyer përvoja në të mirë të dy palëve.

Delegacioni i FARSH-së, para nisjes për në Shqipëri vizitoi edhe Kompleksin Memorial „Adem Jashari" në Prekaz. Kjo vizitë u zhvillua në bazë të bashkëpunimit dypalësh të FSK-së me FARSH-në, në kuadër të vizitave për njohjen e vendeve të rajonit, institucioneve të sigurisë dhe çështjeve të tjera me interes që lidhen me Akademinë e oficerëve të rinj të FSK-së.

Qendra për Studime Universitare realizoi garën „Ujku Garues 2019"

Prishtinë, 10 maj - Në mjediset e kazermës „Adem Jashari" në Prishtinë, sot u mbajt gara "Ujku Garues 2019" për kadetët e vitit të I, II dhe të III të Qendrës për Studime Universitare. Kjo garë u realizua sipas modelit të garës „Ujku Garues", e cila organizohet që disa vite me radhë në Brigadën e Reagimit të Shpejtë (BRSH). Në këtë garë, kadetët e QSU-së, ishin të ndarë në ekipe garuese prej pesë pjesëtarësh, në përbërje të tri gjeneratave, nga viti I, II dhe III.

Gjatë realizimit të garës, kadetët janë sfiduar dhe vlerësuar në gjashtë disiplina garuese: Vrapim 3.2 km, Kalimi i zonës së rrezikshme, Hedhja e granatës, Kalimi i zonës së minuar, Shtyrja e autoblindës „Cobra" dhe Vëzhgimi (identifikimi) i pajisjeve ushtarake nga një distancë e caktuar. Qëllimi i kësaj gare ishte vlerësimi i nivelit të përgatitjes fizike dhe të bashkëpunimit në mes të gjeneratave të ndryshme të kadetëve gjatë aktiviteteve ekipore.

Me rastin e përfundimit të garës, komandanti i QSU-së, majori Vegim Krelani së bashku me stafin udhëheqës të QSU-së ndanë certifikata për tri vendet e para, duke e shpërblyer vendin e parë edhe me pajisje taktike ushtarake. Nga ekipi udhëheqës gara është vlerësuar si mjaft sfiduese dhe e ka përmbushur qëllimin e saj. Kjo garë tashmë është tradicionale dhe organizohet për çdo vit në muajin maj.



Komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hadërgjonaj vizitoi UVK „SHQIPONJA 19"



Tiranë, 19 maj - Komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë i FSK-së, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, ka përcjellë nga afër ushtrimin në vendkomandë „Shqiponja 19",i cili po mbahet në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Tiranë, në të cilin ushtrim po merë pjesë edhe Batalioni i Dytë i Reagimit të Shpejtë i FSK-së. Gjenerali Hadërgjonaj, gjatë vizitës, është pritur nga komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes i Forcave Ushtarake të Shqipërisë, gjeneral brigade Bajram Begaj dhe shefi i Shtabit i KDS-së, koloneli Riza Zaja. Gjatë takimit, të dy gjeneralët kanë biseduar për zhvillimet në ushtrimin e përbashkët „Shqiponja 19", si dhe për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit mes Ushtrisë Shqiptare dhe FSK-së. Më pas, komandanti i BRSH-së, gjenerali Hadërgjonaj, vizitoi edhe Qendrën e Simulimit të UVK „Shqiponja 19"dhe përcolli nga afër operacionet e planifikuara sipas skenarit, që Batalioni i Dytë i BRSH-së së bashku me njësitet shqiptare janë duke i kryer gjatë këtij ushtrimi. Ai, më pas, duke i inkurajuar pjesëtarët e BRSH-së, tha se "ky ushtrim është një mundësi shumë e mirë për ne që të stërvitemi bashkë me FARSH-in dhe të shkëmbejmë përvojat me ta". Realizimi i ushtrimit në vend komandë „Shqiponja 19" ka filluar më 20 maj 2019 dhe pritet të përfundojë më 29 maj 2019.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama e dekoroi gjeneralin amerikan Timothy Orr me „Medaljen për Shërbim Vetëmohues“

Prishtinë, 8 maj 2019 - Nën patronatin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Ministrinë e Mbrojtjes u organizua pritje shtetërore për nder të komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës së SHBA-ve, gjeneral majorit Timothy Orr, ku dekorohet me Medalje për Shërbim Vetëmohues.











FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 81 • 5 Korrik 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Presidenti Hashim Thaçi, me rastin e 20 -vjetorit të çlirimit të vendit vizitoi FSK-në



Prishtinë, 13 qershor - Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të vendit dhe hyrjes së trupave të NATO-s si forca paqeruajtëse në Kosovë, sot qëndroi në kazermën „Adem Jashari“ në Komandën e Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë. Presidenti i vendit, njëherësh Komandant i Përgjithshëm i FSK-së, z. Hashim Thaçi u prit me rreshtim të kuadrateve të njësive të FSK-së nga ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Së pari, presidenti Thaçi së bashku me ministrin Berisha dhe komandantin Rama vendosën lule të freskëta tek „Obelisku i të rënëve për liri“ në nderim të jetës dhe veprës së të rënëve. Presidenti Thaçi në fjalën e tij para ushtarakëve të rreshtuar tha: „Sot është kënaqësi e veçantë të jem këtu mesh ju, në këtë ditë historike për shtetin e Kosovës dhe qytetarët e saj. Këto ditë po shënojmë 20-vjetorin e lirisë së vendit dhe popullit tonë. Sot kujtojmë të gjithë dëshmorët e lirisë, luftëtarët trima të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kujtojmë me nderim dhe respekt Komandantin Legjendar Adem Jashari, kujtojmë me nderim dhe respekt sakrificën e çdo qytetari të Kosovës. „Të nderuar ushtarë, nga aspirata dhe angazhimi i popullit për liri keni lindur edhe ju, e kishim Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e transformuam në Trupa Mbrojtëse të Kosovës e pastaj e themeluam edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Para pak muajsh morëm edhe vendimin historik për themelimin e Ushtrisë së Kosovës. Gëzuar juve dhe nderime e respekt më të lartë për punën tuaj profesionale. Urime Kosovë, urime popullit të Kosovës”. „Sot, Forca e Sigurisë së Kosovës është e mishëruar me këtë dëshirë për liri dhe me gatishmërinë për të mbrojtur paqen për çdo qytetarë të Kosovës, në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës. Forca e Sigurisë së Kosovës është Forcë profesionale e standardëve të NATO-s, është Forcë shumetnike që në mënyrën më të mirë pasqyron atë që kemi arritur, atë që kemi ndërtuar së bashku. Po punojmë seriozisht që edhe ne sa më parë të jemi pjesë e NATO-s”, përfundoi fjalimin e tij presidenti i vendit, me rastin e 20-vjetorit të hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë.

Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Kroacisë u prit me ceremoni ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes



Prishtinë, 11 qershor - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti me ceremoni ushtarake në Ministri të Mbrojtjes shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, gjeneral kolonel Mirko Shundov. Në takime të ndara të Ministrit të Mbrojtjes, Rrustem Berisha, dhe komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me gjeneralin kroat Mirko Shundov, u bisedua për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë në fushën e mbrojtjes si dhe u diskutuan planet dhe opsionet për vazhdimin dhe avancimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy ministrive të Mbrojtjes dhe të dy Forcave tona në të ardhmen. Me këtë rast, ministri Rrustem Berisha falënderoi gjeneralin kroat për mbështetjen e Kosovës në ndërtimin e paqes dhe stabilitetit, ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve mbrojtëse si dhe përkrahjen e vazhdueshme, bazuar në praktikat e kaluara nga vetë Kroacia, për anëtarësimin e Kosovës në iniciativa rajonale dhe në rrugën drejt NATO-s. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë takimit me shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjeneralin Shundov, e njoftoi lidhur me procesin e transicionit dhe rrugën e FSK-së drejt ndërtimit të kapaciteteve mbrojtëse bazuar në mandatin e ri. “Për ne Kroacia është partner strategjik në rajon, dhe në kuadër të kësaj, ne diskutuam për bashkëpunimin tonë bilateral si dhe mundësinë e avancimit të bashkëpunimit në të gjitha fushat”, deklaroi gjenerallejtënant Rrahman Rama në konferencën për shtyp, të mbajtur me gjeneralin Shundov, pas takimin kokë më kokë midis dy gjeneralëve. Në fund, gjeneral Rama e falënderoi gjeneralin Shundov për vizitën si dhe kontributin e Ushtrisë Kroate në KFOR dhe në Ekipin Këshillues dhe ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Kroacisë deklaroi se Kroacia vazhdon të japë kontribut për paqen dhe sigurinë në Kosovë, ka zotim të plotë për vazhdimin dhe avancimin e bashkëpunimit si dhe është e gatshme që të ofrojë gjithë ekspertizën dhe përvojën e saj të kaluar që të ndihmojë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në rrugën e anëtarësimit në iniciativa rajonale dhe me gjerë. Kosova dhe Kroacia kanë marrëveshje të nënshkruar bilaterale që nga viti 2012, në kuadër të së cilës për çdo vit realizohet një gamë e gjerë e aktiviteteve të planifikuar me interes të përbashkët.

Ministri Berisha dhe Komandant Rama dekorojnë drejtorin e NALT-it, gjeneralin Becker



Prishtinë, 28 qershor - Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes sot u zhvillua ceremonia e pranim-dorëzimit të autoritetit të drejtorit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s, nga gjeneral brigade Uwe Becker tek gjeneral brigade Michael Oberneyer. Në ceremoni mori pjesë edhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral Lorenco D’Adario, zëvendës shefi i Bundesverit, gjeneral major Thorsten Poschwatta si dhe oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, NALT-it e mysafirë të tjerë.

Në fillim, kryeministri i vendit, z. Ramush Haradinaj ka falënderuar gjeneralin Becker për kontributin e tij për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në si dhe i ka uruar shërbim të suksesshëm në misionin e tij gjeneralit Oberneyer. Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha çmoi lart angazhimin e drejtorit të NALT-it, gjeneral Uwe Becker e sidomos koordinimin dhe bashkëpunimin në fazën shumë të rëndësishme për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Ministri Berisha në fjalën e tij tha:” Sot me rastin e pranim-dorëzimit të detyrës së drejtorit të NALT-it, më lejoni që në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në emrin tim personal ta falënderoj gjeneral brigade Uwe Becker për angazhimin dhe kontributin e jashtëzakonshëm në një periudhë shumë të rëndësishme të zhvillimit tonë. Forca e Sigurisë së Kosovës përgjatë 10 viteve është trajnuar dhe zhvilluar me ndihmën e ekspertëve të NATO-s, përmes ekipeve trajnuese, këshillëdhënëse dhe ndërlidhëse. Falë kësaj ndihme dhe ndihmës dypalëshe të aleatëve, FSK-ja është dhe do të vazhdojë të jetë një forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme, ku llojllojshmëria etnik dhe gjinor është dhe do të mbetet vlerë”.

(vijon në faqen 2)

Ministri Berisha dhe Komandant Rama dekorojnë drejtorin e NALT-it, gjeneralin Becker



(vijon nga ballina)
Më tej, ministri Berisha theksoi se me gjeneralin Becker gjatë kësaj periudhe ka pasur bashkëpunim konstruktiv, të hapur dhe mirëkuptim të ndërsjellë, siç kanë miqtë dhe partnerët në një histori të përbashkët suksesi. Duke iu drejtuar gjeneralit Becker, ai tha: „Gjeneral Becker, me afërsinë tuaj si bashkëpunëtor dhe me kontributin që keni dhënë gjatë mandatit tuaj, keni fituar shumë miq në vendin tonë dhe besoj që Kosova do të zë një vend të veçantë në karrierën dhe në jetën tuaj. Andaj, gjeneral Becker, miku im Uwe, të jemi shumë mirënjohës për gjithë atë që ke bërë për FSK-në dhe Ministrinë e Mbrojtjes“. Gjithashtu, ministri i Mbrojtjes i uroj mirëseardhje drejtorit të ri të NALT-it, gjeneralit Oberneyer duke iu drejtuar me fjalët: „uroj ta vazhdoni dhe ta avanconi punën e mirë që ka bërë gjenerali Becker. Unë ju ofroj bashkëpunim të hapur dhe profesional, me transparencë të plotë që do ta forcojë edhe më tej besimin e ndërsjellë dhe thellimin e raporteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së me NALT-in“. Në fund të fjalës së tij, ministri Berisha i ka shprehur konsideratë të lartë komandantit të KFOR-it, gjeneral D'Adarion për angazhimin e KFOR-it, për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama vuri në pah, së pari, periudhën e ndjeshme në të cilën gjenerali Becker ka shërbyer në Kosovë. Duke iu drejtuar gjeneralit Becker ai tha: „Gjeneral Becker, fillove në një kohë jashtëzakonisht të vështirë. Kur tranzicioni apo transformimi ishin problemi më i madh yni dhe i shoqërisë kosovare, ne filluam bashkërisht për të ndërtuar besim, transparencë dhe përkushtim për të ecur përpara edhe përkundër dilemave të cilat ekzistonin asaj kohe lidhur me tranzicionin e FSK-së. Angazhimi juaj ishte përcaktues në evitimin e keqkuptimeve midis Kosovës dhe NATO-s në rrugëtimin tonë drejt mandatit të ri. Ekipi i NALT-it po kontribuon dhe po ndihmon FSK-në në zhvillimin dhe ngritjen profesionale të saj, andaj puna juaj si drejtor dhe këshilat tuaja dhe të stafit tuaj po e ndihmojnë Kosovën dhe FSK-në në zhvillimin e mekanizmit të sigurisë dhe mbrojtës me standarde të NATO-s. FSK-ja po vazhdon të jetë profesionale, e gatshme dhe kontribuuese në të mirë të gjithë qytetarëve të vendit, pa dallime etnike dhe fetare. Gjeneral Becker, ishit shumë i përkushtuar që FSK-ja të vazhdojë të edukohet, trajnohet dhe të operojë me disiplinë dhe profesionalizëm. Ju siguroj të gjithëve se të tillë do jemi gjithherë, edhe atëherë kur ne të kemi kapacitet e plota ushtarake, vizioni ynë është i qartë: nuk ka rrugë tjetër përveç rrugës së përbashkët me NATO-n“.


Në fund, gjeneral Rama në emër të gjithë pjesëtarëve të FSK-së ka falënderuar gjeneralin Becker për kontributin dhe mënyrën unike të një lideri, ushtaraku dhe miku si dhe i ka dëshiruar mirëseardhje gjeneralin Oberneyer. „Faleminderit Gjeneral Becker, do të jesh pjesë e historisë. Këshillat tuaja më kanë ndihmuar personalisht dhe profesionalisht. Por, të gjitha këto të arritura nuk kishin mund të bëhen edhe pa përkrahjen e ekspertizës që stafi juaj mbart me vete. Ne do të vazhdojmë bashkërisht rrugëtimin e ndërtimit të aftësive të reja në mënyrë graduale, sipas planifikimit edhe me gjeneral Oberneyer. Gjeneral Oberneyer, mirë se erdhe në Kosovë". Në fjalën e tij përshëndetëse, gjenerali Uwe Becker, tha: „Ne kemi arritur një marrëdhënie të shkëlqyeshme pune, në një mjedis të respektit reciprok, besimit dhe transparencës me kolegët tanë të FSK-së. Brenda mandatit tonë përkatës, ne kemi punuar së bashku për një qëllim: zhvillimin e një FSK-je profesionale, me përfaqësim nga të gjitha komunitetet, duke punuar për të mirën e të gjithë qytetarëve në Kosovë“. Para se drejtori i NALT-it, gjeneral Uwe Becker t'i dorëzojë detyrën pasardhësit të tij, në detyrën e drejtorit të NALT-it, gjeneralit Michael Oberneyer, ministri i mbrojtjes Rrustem Berisha dekoroi gjeneralin Becker me Medaljen për shërbim të shquar, ndërsa komandanti i FSK-së e dekoroi me Medaljen për shërbim vetëmohues, në shenjë falënderimi dhe respekti për bashkëpunimin dhe koordinimin e shkëlqyer sa ishte në detyrën e drejtorit të ekipit të NATO-s. Ekipi Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës i NATO-s u krijua në gusht 2016. Misioni i tij është të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të organizatave të sigurisë në Kosovë që përfshinë ofrimin e këshillave dhe mbështetjes me fokus në koordinimin e ndërtimit të kapaciteteve, edukimit dhe trajnimit.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama u prit nga zv. shefi i Shtabit të Ushtrisë Amerikane gjenerali James McConville



SHBA, 06 qershor - Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë vizitës zyrtare në SHBA, pati takim me zëvendës shefin e Shtabit të Ushtrisë Amerikane gjeneralin James C. McConville. Gjatë takimit tema kryesore ishte rritja e bashkëpunimit dhe tranzicioni i FSK-së. Komandanti i FSK-së e njoftoi homologun Amerikan lidhur me procesin e ndërtimit të aftësive të reja, orientimet e FSK-së për të ardhmen, dhe mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në mes të FSK-së dhe Ushtrisë Amerikane. Gjenerali Rrahman Rama theksoi se FSK-ja është e gatshme të kaloj nga konsumues i sigurisë në ofrues të sigurisë. Në vazhdën e takimeve zyrtare gjeneral Rama i shoqëruar edhe nga ambasadorja e Kosovës Vlora Çitaku u takuan edhe me znj. Laura Cooper, zëvendës asistente e Sekretarit të Mbrojtjes për Rusi, Ukrainë dhe Euro Azi. Në takim u diskutuan mundësitë bilaterale në zhvillimin e aftësive të reja. Departamenti i Mbrojtjes dhe Stafi i Bashkuar, vlerësuan lartë punën dhe kredibilitetin e FSK-së në kuadër të mbajtjes së frymës së diversitetit etnik dhe vazhdimin e implementimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit, me mundësi të zgjerimit të bashkëpunimit bilateral për misionin e ri.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama vizitoi Departamentin e Shtetit dhe Këshillin e Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve



SHBA, 07 qershor - Në vazhdën e vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës zhvilloi takime të ndara në Departamentin e Shtetit dhe në Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama i shoqëruar edhe nga ambasadorja e Republikës së Kosovës në SHBA, Vlora Çitaku, në Departamentin e Shtetit u priten në takim nga znj. Susan Falatko. Me këtë rast, komandanti i FSK-së e njoftoi znj. Falatko për progresin e FSK-së në këtë fazë tranzicioni, mundësitë për rritje të bashkëpunimit në mes të dy vendeve mike me qëllim të vazhdimit të ndërtimit të aftësive të reja në bazë të Planit Gjithëpërfshirës për Tranzicionin e FSK-së. Gjithashtu, gjenerali Rrahman Rama u prit edhe nga John Erath zëvendësdrejtor për Evropë, i shoqëruar edhe nga drejtori për Çështje të Evropës z. Williem Berkley. Gjenerali Rrahman Rama i njoftoi zyrtarët e Këshillit të Sigurisë Kombëtare se FSK-ja vazhdon të jetë Forcë profesionale, shumetnike dhe e gatshme për të qenë pjesë e misioneve paqeruajtëse. Zhvillimet dhe zgjerimi i mandatit të FSK-së është në përputhje me Planin. Në fund, komandanti i Ushtrisë së Kosovës ka falënderuar zyrtarët amerikanë në Departamentin e Mbrojtjes dhe Këshillin e Sigurisë Kombëtare për mbështetjen e vazhdueshme që SHBA-të dhe Ushtria Amerikane po i japin Kosovës dhe FSK-së. Komandanti në të gjitha takimet ishte i shoqëruar nga atasheu i SHBA-së në Kosovë dhe atasheu i Mbrojtjes nga Republika e Kosovës në Uashington.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Sekretari i Ushtrisë Amerikane Dr. Mark Esper qëndroi për vizitë në Kosovë



Prishtinë, 03 qershor - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani dhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, janë takuar dje në Prishtinë me sekretarin e Ushtrisë Amerikane, Dr. Mark T. Esper. Zëvendësministri Ramadani dhe gjenerali Rama e falënderuan sekretarin Esper për mbështetjen e vazhdueshme amerikane për sigurinë në Kosovë dhe rajon, duke vlerësuar lart kontributin e trupave ushtarake amerikane në shtetin tonë. Zëvendësministri Ramadani dhe gjenerali Rama u shprehën se ndjeheshin të nderuar të diskutonin me sekretarin Esper mbi thellimin e partneritetit Kosovë-SHBA dhe formësimin e së ardhmes sonë të sigurt e të mbrojtur, për arritjen e objektivit tonë shtetëror e shoqëror drejt NATO-s si dhe për gatishmërinë e Kosovës për të kontribuuar krah për krah me trupat amerikane dhe të NATO-s kudo nëpër botë. Takimi u mbajt të dielën, më 2 qershor 2019, në rezidencën e ambasadorit amerikan në Kosovë, z. Philip Kosnett. Z. Ramadani tha se ky takim ishte një mundësi e mirë për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në që të shkëmbejmë pikëpamjet dhe planet për të ardhmen për sigurinë rajonale. Dr. Mark Esper është sekretari i 23-të i Ushtrisë Amerikane, i cili në nëntor të vitit 2017 është konfirmuar nga Senati Amerikan.Si sekretar i Ushtrisë Amerikane, Dr. Esper është përgjegjës për të gjitha çështjet që ndërlidhen me Ushtrinë Amerikane, përfshirë rekrutimin, organizimin, trajnimin, pajisjen dhe kujdesin për 1.4 milionë pjesëtarë aktivë, Gardën Nacionale, Ushtarët Rezervë, Departamentin e Civilëve të Ushtrisë dhe familjet e tyre.

Gjeneral brigade Enver Cikaqi priti pilotët e rinj të Forcës së Sigurisë të Kosovës



Prishtinë, 03 qershor - Sot në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore njëherësh edhe zëvendëskomandant i FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, priti dy pilotët e posa diplomuar të Ushtrisë së Kosovës, nëntogerin Atdhe Hasani dhe nëntogerin Krenar Voca, të cilët përfunduan me rezultate të shkëlqyera shkollimin për pilot helikopteri në Akademinë Ushtarake në Republikën e Turqisë. Zëvendëskomandanti i FSK-së, gjenerali Enver Cikaqi i uroi dhe i përgëzoi pilotët për sukseset që ata treguan gjatë shkollimit në Akademinë Ushtarake në Turqi. Gjeneral Cikaqi, veç tjerash, tha se "të dy pilotët e rinj të FSK-së që nga sot do të angazhohen në shërbimin aktiv në FSK dhe do të japin kontributin e tyre profesional në ngritjen e Njësisë Ajrore të FSK-së".

Koordinatori i Komitetit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO, Burim Ramadani, prezantoi Kornizën e Komunikimit Strategjik




Prishtinë, 20 qershor - Zyra e Koordinatorit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO, në bashkëpunim me Ekipin Këshillues e Monitorues për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (NALT), si dhe zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, mbajti sot takim informues për prezantimin e Kornizës së Komunikimit Strategjik, për personelin e zyrave të Informimit nga ministritë që janë pjesë e Komitetit ndërministrorë. Në takim, projektin e ri e prezantuan sipas përgjegjësisë: Zëvendësministri i Mbrojtjes, njëherësh edhe koordinator i Komitetit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim të Kosovës në NATO, z. Burim Ramadani, zonja Donjeta Gashi, drejtoreshë e Zyrës për Komunikim me Publikun e Kryeministrisë si dhe këshilltarja për Komunikim Strategjik në NALT, për Ministrinë e Mbrojtjes, zonja Nicolien Wellen. Me këtë rast, zëvendësministri Ramadani i njoftoi zyrtarët mbi nevojën e komunikimit me audiencën vendore dhe ndërkombëtare; me të njëjtat porosi mbi punën, progresin dhe synimin e Kosovës, drejt arritjes së qëllimit për anëtarësim në NATO. Koordinatori Ramadani, kërkoj angazhimin e ministrive, anëtar të Komitetit që të angazhohen në përplotësimin nga fushë veprimtaria e së cilës ministri, të draft kornizë së Komunikimit Strategjik të Ministrisë së Mbrojtjes, që kjo draft- Kornizë të jetë edhe Kornizë e Komunikimit Strategjik të Komitetit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim të Kosovës në Aleancën Veri- Atlantike. Gjithashtu edhe zonjat Donjeta Gashi dhe Nikcolien Wellen, si dhe audienca e pranishme me diskutime, shprehën nevojën për një koordinim të mirë të gjitha dikastereve të përfshira në përplotësimin dhe përfundimin e një Kornize të Komunikimit Strategjik që do unifikonte komunikimin me audiencën në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe marrëdhënieve me jashtë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Turqia i dhuroi FSK-së një Autoblindë për qëllime mjekësore në vlerë mbi 463 mijë dollar



Prishtinë, 21 qershor Sot, në Kazermën „Adem Jashari" të FSK-së, në Prishtinë, u mbajt ceremonia e pranim- dorëzimit të Autoblindës të ndihmës së parë „Cobra 4x4" donacion nga Republika e Turqisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila me të gjitha pajisjet rezervë kapë vlerën e përgjithshme prej 462.457 dollar. Marrëveshja për pranim-dorëzimin e këtij donacioni u nënshkrua nga atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovë, nënkoloneli Ismail Ersoz dhe oficeri i Departamentit të Logjistikës në Ministrinë e Mbrojtjes, kapiteni Remzi Bushi. Ky donacion si dhe donacionet e shumta të tjera, të cilat i janë dhuruar FSK-së, janë rezultat i bashkëpunimit të mirëfilltë në mes të FSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë, duke u bazuar në marrëveshjen për ndihmën financiare në ngritjen dhe profesionalizmin e FSK-së.

Kadetët e diplomuar të FSK-së japin betimin për shërbim ndaj vendit





Ferizaj, 27 qershor - Sot, në kazermën „Skënderbeu“ të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, u mbajt ceremonia e diplomimit të tetë kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe dy kadetëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të shkolluar në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, të cilët u graduan me gradën e nëntogerit si dhe morën emërimet në detyrë për shërbim si oficerë të rinj në FSK-së, përkatësisht në ushtrinë shqiptare. Në këtë ceremoni morën pjesë kryeministri i Republikës së Kosovës Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ministri i Punëve të Brendshme Ekrem Mustafa, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjenerali Uwe Becker, komandanti i QSU-së, major Vegim Krelani si dhe deputetë, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së, KFOR-it, atashe ushtarakë dhe të mbrojtjes nga shtete të ndryshme, familjarë të kadetëve dhe mysafirë të tjerë.

Me këtë rast, kryeministri Haradinaj duke uruar kadetët për diplomimin, emërimin dhe gradimin si dhe për shërbimin me vetëmohim ndaj vendit tha se këta kadetë janë gjenerata e parë që diplomojnë pas votimit në Parlament, edhe pas mandatimit të FSK-së si Forcë Mbrojtëse e Kosovës duke u bërë kështu vetë historia. „Ju uroj për gradimin dhe ju falënderoj për shërbimin e deritashëm. Ju ftoj që të shërbeni me nder në ushtrinë e Kosovës, për popullin e Kosovës, për paqen dhe për rreshtin e ushtrive të paqes të cilit ne i takojmë dhe do t'i takojmë, pra së shpejti në NATO, të cilës i prin SHBA-ja”, tha kryeministri Haradinaj, duke vazhduar se Kosova si vend, vjen prej sfidave e tragjedive dhe ende është e sfiduar, por nuk bën garë me të keqen, garën e bëjmë me të mirën dhe synojmë t'iu takojmë popujve të lirë, ushtrive të popujve të lirë, atyre ushtrive që garantojnë paqen.

Ministri Rrustem Berisha tha se ka nderin që sot të merr pjesë në këtë datë të rëndësishme për karrierën dhe jetën e kadetëve, por edhe FSK-në dhe shtetin e Kosovës. „Sot duhet të jeni krenarë për arritjet tuaja dhe të zotoheni që ta nderoni uniformën e FSK-së, ta nderoni Atdheun dhe të mbroni paqen, liritë dhe shtetin e ndërtuar me shumë sakrificë”, tha ministri Berisha. Ju jeni pjesë e një Force profesionale, të besueshme, shumetnike që jemi duke e ndërtuar bashkë me aleatët tanë. Synimi ynë strategjik është anëtarësimi në NATO dhe unë jam i bindur se pa marrë parasysh sfidat gjeopolitike të çastit, me djemtë dhe vajzat si ju e ardhmja euroatlantike e Republikës së Kosovës është e sigurt. Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha, se të gjithë që jemi sot bashkë këtu, erdhëm edhe për t'i përgëzuar kuadrot e reja që po i bashkohen FSK-së. „Nuk ka vlerë më të madhe se kur ke oficerë të devotshëm, profesionalë dhe me vlera të larta njerëzore në radhët e organizatës“. „Ju kadetë që po diplomoni sot, ju siguroj që keni bërë gjënë më fisnike që mund ta bënit, të përgatiteni për katër vite rresht. Jeni përgatitur për të mbrojtur qytetarët dhe për të kontribuar për një botë më të mirë për fëmijët tanë dhe të ardhmen e këtij vendi. Oficerët e rinj që kanë diplomuar në Qendrën për Studime Universitare po na bëjnë krenarë çdo herë me shkollime, trajnime dhe gara të ndryshme jashtë vendit“. Në këtë ceremoni u ndanë Diploma për 10 kadetët e diplomuar, ndërsa me medalje u nderua kadeti Dritëro Bajrami për rezultate të larta në përvetësimin e programit mësimor përgjatë katër viteve të studimeve, si dhe kapteri Naim Smakolli instruktor në Qendrën për Studime Universitare u dekorua me „Medalje për shërbim vetëmohues“ për arritje të larta në planifikimin dhe zbatimin e plan-programit mësimor në QSU-së, gjatë vitit akademik 2018/2019.



Në fund të ceremonisë, kadetët e sapo diplomuar në Qendrën për Studime Universitare dhe në R.I.T Kosova (A.U.K) tani nëntogerë të FSK-së: Ardit Deliu, Ardit Gashi, Dritëro Bajrami, Ilirianë Bunjaku, Jeta Berisha, Samet Kadrija, Valdrin Ismajli dhe Ylli Abazi, të cilët njëherësh janë emëruar në detyra si komandues të togës në batalionet e Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, dhanë betimin për shërbim. Ndërsa, kadetët e sapo diplomuar në QSU dhe tani nëntogerë nga Republika e Shqipërisë, Denis Bitri dhe Endrit Hate do të sistemohen në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Ushtarakët e Kosovës dhe të Shqipërisë trajnohen nga instruktorët amerikanët



Prishtinë, 26 qershor - Në Kompaninë e Deminimit në Prizren është duke u realizuar trajnimi katër javor për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe ata të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Trajnimi „Asgjësimi i mjeteve shpërthyese niveli i II-Trajno Trajnerët“ i cili është duke u mbajtur nga ekipi i ekspertëve të Njësisë për Eliminimin e Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyera (EOD) të ushtrisë amerikane, ka filluar më 21 qershor dhe do të zgjasë deri më 12 korrik. Në trajnim janë duke marrë pjesë gjithsej 21 pjesëtarë, 16 nga FSK–ja dhe 5 nga FARSH-ja. Përveç pjesës teorike, në javën e dytë të trajnimit u zhvillua edhe pjesa praktike, ku pjesëtarët patën rastin që të gjitha mësimet e mësuara në teori t'i zbatojnë edhe në praktikë, duke demoluar disa mjete të pashpërthyera në fshatin Harilaq.

Trajnimi u vlerësua lart nga të gjithë pjesëmarrësit dhe në veçanti nga përgjegjësi i ekipit të FSK-së, kapter Islam Kadriu, i cili i falënderoi instruktorët amerikanë për këtë mundësi si dhe kolegët nga Shqipëria për bashkëpunimin e mirë gjatë këtij trajnimi dhe për sjelljen e përvojave të tyre mjaft të rëndësishme për ushtarakët e FSK-së. Ndërsa, shefi i Seksionit të Xhenioseve në EOD-së në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse të FARSH-së, major Klodian Nuredini, ndër të tjera shprehet „Ky trajnim i cili është zhvilluar edhe vitin e kaluar në Shqipëri është i domosdoshëm për ne, pasi që nga të gjitha këto që mësojmë gjatë këtyre trajnimeve dhe shkëmbimeve të përvojave me pjesëtarët e FSK-së, në të ardhmen do të na ndihmojnë të realizojmë trajnime të tilla për pjesëtarët tanë“. Nga ana e tij, Fernando Aguilera, rreshter teknik i EOD–së, njëherësh udhëheqës i ekipit për deminim nga ushtria amerikane, shprehet mjaft i impresionuar nga interesimi që treguan ushtarakët e të dy ushtrive për t'u pajisur me sa më shumë njohuri gjatë këtij trajnimi. „Është hera e dytë që jam këtu. Ne jemi këtu për t'iu ofruar përvojat tona këtyre dy shteteve. Po ashtu dëshirojmë ta fuqizojmë këtë lidhje ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë". Ky trajnim ashtu si edhe trajnimet tjera me instruktorët amerikanë janë në vazhdën e trajnimeve për realizimin e Planit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

FSK-ja realizoi me sukses trajnimin fushor „Komando dhe Bjeshkatari“



Prishtinë, 21 qershor - Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi së bashku me komandantin e Brigadës së Reagimit të Shpejtë gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj dhe komandantin e Kontingjentit të KFOR-it, Turk në Kosovë, kolonelin Numan Bash, dje vizituan pjesëtarët e Batalionit të Parë të BRSH-së, në Gjilan, gjatë realizimit të ushtrimit „Komando dhe Bjeshkatari“ nga instruktorët e ushtrisë turke. Pjesëtarët e FSK-së, gjatë realizimit të këtij ushtrimi, në terren të hapur, në vendin e quajtur „Guri i Plakës“ në Komunën e Drenasit, para vizitorëve, demonstruan ushtrimet që i kanë mësuar gjatë këtyre 8 javëve të trajnimit, si: lëshimi me litar, ngjitja me litar, kalimi nga një bjeshkë në tjetrën përmes litarit si dhe kalimi i lumit me litar. Me këtë rast, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi u nda mjaft i kënaqur nga gjithë ajo që pa, gjatë realizimit praktik të trajnimit, dhe nga ato, që dëgjoi nga instruktorët e këtij trajnimi. „Ju përgëzoj për realizimin me sukses të këtij trajnimi mjaft sfidues „Komando dhe Bjeshkatari“, i cili u realizua në terrene të ndryshme dhe të panjohura. Ju gjatë tërë kohës na bëni të ndihemi mjaft krenar me sukseset, interesimin për të përfituar njohuri dhe kolegjialitetin që keni krijuar me instruktorët turq" tha gjeneral Cikaqi. Ndërsa, komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hadergjonaj, pasi i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për mbarëvajtjen me sukses të këtij trajnimi, Ai, njëherësh e vlerësoi lartë rëndësinë e këtij trajnimi për FSK-në, në përgjithësi. Në trajnimin „Komando dhe Bjeshkatari“ morën pjesë 25 pjesëtarë të BRSH-së, i cili trajnim ka filluar të realizohet me 23 prill 2019, dhe pritet të përfundojë me 27 qershor 2019, në Gjilan. Trajnimi do të zgjasë 9 javë, dhe po realizohet nga ekipi i instruktorëve të KFOR-it turk.

Nënkoloneli Ejup Maqedonci diplomon në Kolegjin e Luftës në SHBA



Prishtinë, qershor - Gjatë këtij viti akademik, nënkoloneli i FSK-së, Ejup Maqedonci, ka diplomuar në Kolegjin e Luftës në SHBA. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë vizitës syrtare në SHBA, ka marrë pjesë edhe në ceremoninë e diplomimit të nënkolonelit Maqedonci në Kolegjin e Luftës, gjenerata 2019, ku është pritur nga komandanti i Kolegjit, gjeneral majori John Kem. Me këtë rast, të dy gjeneralët kanë biseduar për rëndësinë e këtij institucioni në zhvillimin dhe edukimin e liderëve si dhe bashkëpunimin edhe në të ardhmen. Gjenerali Rrahman Rama, në fjalën e tij, është shprehur, se: „Ishte kënaqësi të dëgjoj nga Komandanti i këtij Kolegji, lidhur me profesionalizmin dhe dedikimin e treguar të kadetëve dhe oficerëve të FSK-së. Nënkoloneli Maqedonci diplomoi dhe magjistroi me rezultate superiore, të vlerësuara nga Kolegji i Luftës. Unë si Komandant i FSK-së, jam krenar me vajzat dhe djemtë e FSK-së, që po zhvillohen dhe edukohen në institucionet më prestigjioze të Ushtrisë Amerikane. FSK-ja është e orientuar në ndërtimin e aftësive bazuar në doktrinën Amerikane, me qellim të ndërveprueshmërisë në të ardhmen", tha komandanti i FSK-së, gjeneral Rama.

Oficeri i FSK-së, Premtim Rashiti, doktor i Shkencave të Mjekësisë



Forcës së Sigurisë të Kosovës i është shtuar edhe një doktor i shkencave të mjekësisë. Ass. Dr. Premtim Rashiti, pjesëtar rezervë i FSK-së, në Brigadën e Reagimit të Shpejtë. Ditë më parë, oficeri i FSK-së, Premtim Rashiti, ka mbrojtur me sukses dhe vlerësim maksimal Disertacionin e Doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, me temën: „Roli i adiponektinës në parashikimin e sëmundjeve të artereve koronare dhe raporti i saj me parametrat antropometrik relevant", duke marrë titullin „Doktor i Shkencave të Mjekësisë". Mbrojtja e Disertacionit të Doktoratës së z. Rashiti u përcoll nga një numër i madh intelektualësh të profileve të ndryshme, shumë pjesëtarë të FSK-së, oficerë të lartë, si dhe zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Xhevahir Geci. Tema e kësaj doktorate, me aktualitetin dhe origjinalitetit e saj zgjoi interesim të madh te të gjithë të pranishmit. Kapitali shkencor i doktorit të ri të shkencave të mjekësisë, Prof. Dr. Premtim Rashiti, do të jetë i mirëseardhur dhe vlerë e shtuar për FSK-në, dhe në veçanti për fushën e saj të mjekësisë.

Rreshterë majorët e FSK-së diplomohen në Akademinë e Rreshterë Majorëve në SHBA



Texas-SHBA, 24 qershor - Korit të nënoficerëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës iu shtuan edhe tre rreshterë majorë të diplomuar në Akademinë e Rreshterë Majorëve në El Paso, Texas të SHBA-ve; Rreshterë majorët Shukri Abdullahu, Blerim Ramusholli dhe Fatmir Rama përfunduan me sukses Kursin për rreshter major, i cili njëherësh tregon për përsosmërinë e zhvillimit të NOF (Rreshter Majorit) si në ushtrinë amerikane ashtu edhe në FSK. Përgjatë një viti studimesh, kërkimesh dhe shkëmbimi përvojash, të tre rreshterë majorët kaluan nëpër gjashtë departamente të ndryshme, ku pa mëdyshje nuk mungoi suksesi i tyre. „Ndihem shumë krenar me të tre rreshterë majorët në fjalë“, u shpreh rreshter majori i Komandës së Forcave Tokësore, Fetah Zejnullahu, i cili ishte i pranishëm në ceremoninë e diplomimit të tyre. Të tre rreshterë majorët e FSK-së, Abdullahu, Ramusholli dhe Rama, gjatë shkollimit dhe trajnimit në Akademinë e Rreshterë Majorëve në SHBA, e cila njihet si akademia më prestigjioze për përgatitjen e NOF-ve, u dalluan për gatishmëri, profesionalizëm dhe vlera të larta ushtarake.

Shefi i Shtabit të KFOR-it vizitoi Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së



Prishtinë, 13 qershor - Gjeneral brigade John Boyd (i Ushtrisë së SHBA-ve), aktualisht shef i Shtabit të KFOR-it, vizitoi Regjimentin e Mbrojtjes Civile (RMC) dhe Qendrën Rajonale të Trajnimit për Kërkim- Shpëtim (QRTKSH) në kazermën „Evropianët e rinj“ në Pomozotin. Me këtë rast, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri e njoftoi gjeneralin amerikan me kapacitetet dhe aftësitë e këtij Regjimentit, përfshirë këtu Njësinë e Kërkim- Shpëtimit, Mbrojtjes Kimike Biologjike dhe Atomike (HAZMAT), Njësinë për Eliminimin e Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyera (EOD) si dhe me operacionet të cilat Regjimenti i Mbrojtjes Civile është duke i realizuar. Gjenerali Boyd, gjatë qëndrimit të tij në Qendrën Rajonale të Trajnimit për Kërkim–Shpëtim, ka parë nga afër disa prej kapaciteteve trajnuese, si kornizën e helikopterit, si dhe është njoftuar konkretisht me mënyrën e shfrytëzimi të tyre. Po ashtu është njoftuar edhe me projektet që parashihen të zhvillohen në të ardhme, meqenëse edhe numri i trajnimeve në këtë Qendër që deri me tani ishte 6 ka shkuar në 24 trajnime. Vlen të ceket se në QTKSH nuk trajnohen vetëm pjesëtarët e FSK-së, por edhe pjesëtarë nga Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, si dhe pjesëtarë të ushtrive të shteteve si Shqipëria, Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut. Kjo Qendër ka ngritur edhe Ekipin Mobil të Trajnimit i cili trajnon pjesëtarët e huaj nëpër vendet e tyre.

Në fund, gjeneral Boyd e përgëzoi kolonel Hazirin për sukseset dhe reputacionin e Qendrës Rajonale të Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në nivel ndërkombëtar, duke e siguruar se edhe në të ardhmen do të vazhdojë ta mbajë vëmendjen te zhvillimi i saj.

Qendra për Studime Universitare realizoi ushtrimin fushor „Kampi i Avancuar 2019”



Mitrovicë, 18 qershor - Kadetët e Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, përfunduan dje ushtrimin fushor „Kampi i Avancuar 2019”. Ushtrimi është realizuar nga data 06 deri më 18 qershor 2019, në fshatin Kovaçicë të Komunës së Mitrovicës, ndërsa ushtrimi në përgjithësi përfshiu rajonin e Prishtinës, Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Podujevës. Në ditën e fundit të ushtrimit, për të parë nga afër demonstrimet e kadetëve ishin edhe komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama së bashku me komandantin e Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqin, zv. komandantin e KDS-së, kolonelin Mehmet Lladrovcin, këshilltarin e komandantit të FSK-së, kolonelin Jeton Dreshajn, këshilltarin britanik të Komandantit të FSK-së, nënkolonelin Jake White, drejtorin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Ismail Smakiqin, si dhe oficerë të lartë të FSK-së. Së pari, vizitorët panë në detaje ndërtimin e Kampit, për të vazhduar më pas me një informim të shkurtër nga komandanti i QSU-së majori Vegim Krelani, i cili i njoftoi të pranishmit me qëllimin dhe mbarëvajtjen e ushtrimit që nga dita e parë deri në përfundim të tij. Më pas, vizitorët, realizuan vizita në Komandën e Kompanisë, ku nga kadetët e vitit të katërt të QSU-së u njoftuan me angazhimet e tyre gjatë këtij ushtrimi si dhe me sfidat që janë përballur gjatë realizimit të tij. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, pasi që i pa nga afër të gjitha këto demonstrime dhe prezantime, shprehet mjaft i kënaqur me përgatitjen e përgjithshme të kadetëve dhe me sukseset e QSU-së në përgjithësi. „Jam i vetëdijshëm që ky ushtrim ka qenë një sfidë për të gjithë e në veçanti për kadetët e vitit të parë, por nga gjithë kjo që pash, jam mjaft i kënaqur dhe krenar më të arriturat e QSU-së. Ju përgëzoj të gjithëve për një përmbyllje kaq të suksesshme të vitit. Më gëzon shumë fakti që në këtë akademi kemi edhe kolegë nga Shqipëria. Në të ardhmen synojmë që këtë akademi ta bëjmë Akademi Ndërkombëtare. Pra vazhdoni të punoni me angazhim, përkushtim dhe përgjegjësi sa më të lartë, pasi që e ardhmja e FSK-së jen ju”, -tha ndër të tjera gjeneral Rama. Qendra për Studime Universitare organizon ushtrime të tilla fushore çdo vit, me qëllim të vlerësimit të aftësive të kadetëve të QSU-së, në udhëheqjen, planifikimin dhe zbatimin e operacioneve luftarake.

Në Ditën Botërore të Dhurimit të Gjakut

FSK-ja donatori më i madh i gjakut në Kosovë



Prishtinë, 15 qershor - Aktivitetit të dhurimit të gjakut iu bashkuan edhe 60 pjesëtarë të FSK-së, duke dëshmuar edhe një herë së pjesëtarët e saj, janë ndër dhuruesit më të rregullt të gjakut. Me këtë rast, shefi i Departamentit të Planifikimeve, koloneli Sefer Isufi, para mediave dhe të pranishmeve, duke u bazuar në misionin dhe detyrat e institucionit të FSK-së, shprehi gatishmërinë e pjesëtarëve të FSK-së në mbështetje të qytetarëve të vendit: „Pjesëtarët e FSK-së janë të përkushtuar në ofrimin e mundësive të tyre fizike dhe profesionale, në përmbushjen e misionit të tyre të shenjtë në mbështetje të qytetarëve. Edhe ky aksion, të cilit sot i jemi bashkuar rreth 60 pjesëtarë, është në vazhdën e mbështetjes së institucioneve tona dhe qytetarëve të vendit". Ndërsa, drejtoresha e QKKTGJ-së, Dr. Bukurije Zhubi vlerësoi lart interesimin e shumë qytetarëve dhe sidomos të pjesëtarëve të dy institucioneve të sigurisë, FSK-së dhe Policisë së Kosovës, të cilët çdoherë u janë përgjigjur pa hezitim kërkesave për dhurimin e gjakut. "Jemi mbledhur këtu për të shënuar këtë ditë me një manifestim kaq të madh, të cilin e madhështon edhe më shumë prania e pjesëtarëve të FSK-së dhe Policisë së Kosovës, që gjithherë është kënaqësi t'i kemi në mesin tonë", shprehet drejtoresha e Bukurije Zhubi. FSK-ja në bashkëpunim me Kompaninë e Mjekësisë dhe Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, dy herë në vit organizon aktivitetin humanitar të dhurimit të gjakut, ku me vullnetin e mirë dhe gatishmërinë që tregojnë pjesëtarët e FSK-së arrijnë që të grumbullojë mbi 1000 doza gjak, të cilat i dhurohen Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut për nevojat e pacientëve në spitalet tona. Dita Botërorë e Dhurimit të Gjakut shënohet çdo vit në Kosovë. Këtë vit, zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë e kanë organizuar këtë aktivitet, me qëllim të vetëdijesimit dhe sensibilizimit të popullatës për të dhuruar gjak dhe për të shpëtuar jetët e të gjithë atyre që kanë nevojë.

FSK-ja kryen me sukses operacionin për ri-ambalazhimin e materieve të rrezikshme



Pejë, 27 qershor - Kompania e Mbrojtjes Kimike, Atomike dhe Biologjike (MKAB) e FSK-së, në një operacion sfidues ka përfunduar me sukses operacionin për ri-ambalazhimin e materieve të rrezikshme të Kompanisë „Swis Oil" në Pejë. Pas një pune profesionale, FSK-ja ka arritur që të ri- ambalazhojë gjithsej 322 fuqi, të cilat vlerësohet që tashmë janë në gjendje shumë të mirë. MKAB-ja së bashku me aktorët mbështetës do të vazhdojë monitorimin e të gjitha materieve dhe do të rekomandojë masat e sigurisë. Operacioni është realizuar në tërësi nga Kompania e Mbrojtjes Kimike, Atomike dhe Biologjike nën udhëheqjen e kapiten Sevdaim Vitia dhe është mbështetur nga përfaqësuesi i KFOR-it, nënkolonel Helder Souares (përgjegjës për materie të rrezikshme në kuadër të KFOR-it) dhe nënkolonel Todd Essing, përfaqësues nga Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK (NALT) si dhe në bashkëpunim me Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pas analizave të zhvilluara nga MKAB, KFOR, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ishte konstatuar gjendje alarmante e materieve të rrezikshme në lokacionin e „Swis Oil'' dhe rekomandimi profesional për Kompaninë „SWIS OIL'' ishte që të ndërmerren masa për plotësimin e kushteve për trajtimin e këtyre materieve të rrezikshme. Materiet janë trashëguar nga ish-Kombinati i Lëkurë-Këpucëve, që ka qenë fabrikë për përpunimin e lëkurës dhe prodhimin e këpucëve. Me hyrjen e masave të dhunshme në vitet 90-ta dhe largimin e punëtorëve nga vendi i punës, në depot e kësaj fabrike kanë mbetur një sasi e madhe e materieve të rrezikshme të cilat janë përdorur si lëndë e parë në prodhim, kryesisht ngjyra dhe vajra. MKAB-ja në bazë të misionit që ka, në bashkëpunim me KFOR-in, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe drejtuesit e Kompanisë „Swis Oil'' vazhdimisht ka monitoruar fuqitë me materiet kimike, por pasi që me kalimin e kohës gjendja e këtyre materieve u keqësua dukshëm, atëherë autoritetet përgjegjëse ndërmorën operacionin për ri-ambalazhimin e këtyre materieve, të cilat edhe janë vendosur në një lokacion të sigurt. Ri-ambalazhimi ka përfunduar dhe materiet janë vendosur në fshatin Gorozhdec, ku tashmë janë deponuar dhe sistemuar në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrjedhje. Sipas inspektimeve që kemi bërë në të gjithë territorin e Kosovës gjendja e materieve të rrezikshme nuk është e mirë në disa vende të Kosovës, prandaj sipas dinamikës dhe koordinimit do të fillojmë me operacione të ngjashme në mënyrë që qytetarët e Republikës së Kosovës të ndihen të sigurt në mjediset ku ata jetojnë.

Zjarrfikësit dhe pjesëtarët e FSK-së kryejnë Kursin për Mbijetesë dhe Shpëtim në Ujëra

Prishtinë, 18 qershor - Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në Pomozotin, u mbajt ceremonia e certifikimit të zjarrfikësve dhe pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kanë përfunduar Kursin për mbijetesë dhe shpëtim në ujëra. Gjatë trajnimit një javor dhe mjaft intensiv pjesëmarrësit mësuan për mënyrat e shpëtimit dhe dhënien e ndihmës mjekësore, si persona të parë në vendngjarje, personave që ballafaqohen me rrezik mbytjeje apo vështirësi të tjera në ujëra. Ata mësuan se si të krijonin pajisje të improvizuara lundrimi me mjete përreth tyre, si dhe praktikuan improvizimin e litarëve me rroba, rripa, lidhëse çizmesh etj. për shpëtimin e viktimave nga mbytja. Gjithashtu pjesëmarrësit lundruan nëpër lumenj, në mënyrë që të mësonin praktikisht sa më shumë teknika për kërkimin e viktimave në ujëra. Me stërvitjen që po zhvillohej ditë e natë, një nga detyrat më të vështira ishte përfundimi i notit në Liqenin e Batllavës, në një distancë mjaft të gjatë dhe në kushte të papërshtatshme notimi, me uniforma të veshura dhe me çanta në shpinë, të cilat duheshin përdorur si mbështetëse lundrimi. Mysafirë në ceremoninë e certifikimit ishin; Shefki Abdullahu, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, Miran Demiri, zv. shef i AME-së, Latif Zeka, drejtor i Departamentit të Zjarrfikësve dhe Malë Gashi zv. komandanti i zjarrfikësve. Në fund, koloneli Shaip Haziri zhvilloi një takim me të ftuarit dhe ku diskutuan për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

FSK-ja me sukses zhvilloi ushtrimin fushor „UJKU 02/19“



Rahovec, 28 qershor - Në kuadër të Planit të trajnimeve dhe aktiviteteve për vitin 2019, Kompania 2A e Batalionit të Dytë të BRSH-së e Forcës së Sigurisë të Kosovës ka zhvilluar ushtrimin fushor „UJKU 02/19“. Më ketë ushtrim fushor, Kompania 2A e ka përfunduar ciklin e trajnimeve “Gjenerimi i Forcës” për vitin 2019, i cili ka filluar më 08 prill 2019 dhe është përmbyllur me ushtrimin fushor „UJKU 02/19“, që është mbajtur nga data 25-27 qershor 2019. Ushtrimi fushor u mbajt në territorin e Komunës së Rahovecit, ku Kompania 2A, të gjitha intervenimet i ka realizuar nga Kampi i vendosur në bjeshkët e Rahovecit. Qëllimi i këtij ushtrimi ishte testimi i aftësive taktike të fituara gjatë trajnimeve „Gjenerimi i Forcës“, për gjithë personelin e Kompanisë 2A, në intervenime, me theks të veçante në operime, si: operacione urbane, pikë kontrolli, okupimi i bazës patrulluese, patrullim, kordon e kërkim, ngritje e pikës së vëzhgimit, si dhe duke ju dhënë liri veprimi të gjithë liderëve në të gjitha nivelet e komandimit gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të operacioneve, duke aplikuar komandim në mision, bashkëpunimi me institucionet e sigurisë dhe agjencitë civile në aspektin bashkëveprues në raste emergjente për t’ iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës. Në UF morën pjesë: Batalioni i Dytë i BRSH-së, Policia e Kosovës, Drejtoritë e Shërbimeve Publike të Komunës së Rahovecit, Qendra Emergjente, Kryqi i Kuq, Zjarrfikësit, Qendra Rinore Rahovec, Njësitë e specializuara të FSK-së, Kërkim-Shpëtimi, MKAB-ja dhe EOD-ja. Ushtrimi fushor „UJKU 02/19“ i Kompanisë 2A, u përcoll nga zv. KOMBRSH kolonel Hysen Dreshaj, i cili pjesëtarët e Kompanisë 2A dhe të gjithë pjesëmarrësit e këtij ushtrimi i përgëzoi për punën profesionale, angazhimin dhe motivimin që treguan gjatë realizimit të këtij ushtrimi. Ai, gjithashtu kërkoi nga ta, të vazhdojnë më përkushtim punën në arritjen e profesionalizmit dhe të zhvillimit taktik të detyrave në të ardhmen. Ai, falënderoi Komunën e Rahovecit si nikoqir i këtij ushtrimi, Policinë e Kosovës, Agjencitë civile, Qendrën Rinore në Rahovec, Njësitë e specializuara të FSK-së, Kërkim-Shpëtimin, MKAB-në dhe EOD-në, për profesionalizmin e treguar gjatë këtij ushtrimi. Ndërsa, komandanti i Batalionit të Dytë të BRSH-së, nënkoloneli Astrit Haliti vlerësoi se qëllimi përfundimtar dhe objektivat e ciklit „Gjenerimi i Forcës“ janë përmbushur. Ndërsa, kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi falënderoi FSK-në për organizimin e këtij ushtrimi të përbashkët me Komunën e Rahovecit, e në veçanti falënderoi Batalionin e Dytë të BRSH-së, Policinë e Kosovës dhe agjencitë që morën pjesë në këtë ushtrim të planifikuar nga BAT 2 i BRSH-së. Gjatë këtij ushtrimi, pjesëtarët e Kompanisë 2A, dëshmuan se janë mjaft të përgatitur në përmbushjen e detyrave që u caktohen dhe se njohuritë e fituara gjatë trajnimit „Gjenerimi i Forcës“ i kanë bërë me profesionalizëm, motiv dhe përkushtim të lartë.

FSK-ja mbështet komunitetin kroat në Janjevë

Prishtinë, 24 qershor - Forca e Sigurisë së Kosovës me kapacitetet e saj po realizon projekte humanitare në ndihmë të të gjithë qytetarëve të vendit. Kësaj radhe, pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të Brigadës së Mbështetjes Operacionale kanë realizuar projektin humanitarë në përkrahje të komunitetit kroat në Janjëvë, Komuna e Lipjanit. Projekti ka të bëjë me hapjen e traseve dhe zgjerimin e rrugës në një gjatësi prej 1200 metrash. Batalioni i Xhenios gjatë realizimit të këtij projekti është mbështetur edhe nga vet banorët e komunitetit kroat dhe Komuna e Lipjanit. Ditë më parë, punimet e kësaj rruge i ndoqi nga afër edhe shefi i Mbrojtjes i Republikës së Kroacisë, gjenerali Mirko Shundov, gjatë vizitës së tij në Kosovë, u shpreh mjaft i kënaqur dhe shumë falënderues për kujdesin e FSK-së ndaj komunitetit kroat që jeton në Kosovë. Punimet e këtij projekti i përcollën nga afër gjeneral brigade Naim Haziri, komandant i Brigadës së Mbështetjes Operacioneve, zv. komandanti i MBO-së, koloneli Avdi Raci dhe komandanti i Batalionit të Xhenios, nënkolonel Rifat Maloku. Gjenerali Naim Haziri ka vlerësuar lart punën profesionale të Batalionit të Xhenios, dhe ka premtuar se: „FSK-ja gjithmonë është e gatshme të mbështesë operacionet në ndihmë të popullatës. Ky është edhe misioni ynë, të jemi në mbrojtje të popullatës së Kosovës pa dallim etnie, në çfarëdo situate që është e nevojshme”, tha ai në fund.

Në FSK përfundoi seminari „Zhvillimi i Nënoficerëve Shtaborë”



Prishtinë, 07 qershor - Në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë, sot përfundoi seminari me temën: „Zhvillimi i Nënoficerëve Shtaborë“ i cili u realizua në periudhën kohore 03-07.06.2019. Ky seminar u mbajt nga një ekip ekspertësh i Gardës Kombëtare të Ajovës, të mbikëqyrur nga rreshter majori Fails dhe rreshter majori i FSK-së, Genc Metaj. Rreshter majori Metaj e vlerësoi lart rëndësinë e këtij seminari për FSK-në në përgjithësi dhe në veçanti për nënoficerët e FSK-së. „Ky seminar është mjaft i rëndësishëm për FSK-në, pasi që përgatit nënoficerët shtaborë për pjesëmarrje në operacione të ndryshme, me fokus në ushtrime në vendkomandë dhe në procese vendimmarrëse ushtarake, duke përfshirë të gjithë sektorët shtaborë”. Të kënaqur nga mbarëvajtja e këtij trajnimi u shprehen edhe trajnerët amerikanë, të cilët vlerësuan lart interesimin e pjesëmarrësve të FSK-së në trajnim për të përfituar sa më shumë nga eksperiencat amerikane. Vlen të ceket se ky seminari ishte në vazhdën e bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku pjesëmarrës ishin 19 pjesëtarë nga njësitë e FSK-së, të cilët gjatë një jave sa zgjati seminari shkëmbyen eksperienca të ndryshme.

Certifikohen pjesëtarët e FSK-së të „Njësisë për Siguri Fizike“



Istog, 29 qershor - Në Brigadën e Reagimit të Shpejtë është mbajtur ceremonia e certifikimit të 198 pjesëtarëve, të cilët kanë përfunduar me sukses trajnimin „Njësia për Siguri Fizike“. Në ceremoni mori pjesë Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, gjeneralmajor Gzim Hazrolli, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj dhe komandantë të batalioneve të BRSH-së. Ministri Berisha në fjalën e tij i ka uruar të posa certifikuarit për suksesin e treguar gjatë trajnimit, duke vlerësuar lartë rëndësinë e kësaj njësie si komponent e domosdoshme për rritjen në shkallë edhe më të lartë të sigurisë fizike të kazermave të FSK-së, pronës dhe objekteve të saj. Ai, me këtë rast, ju ka uruar mirëseardhje në FSK, duke ju uruar sukses në punë dhe jetën familjare. Gjeneral majori Gëzim Hazrolli pasi uroi gjithë pjesëmarrësit e këtij trajnimi për suksesin dhe rezultatin e arritur gjatë trajnimit, përgëzoi për punën profesionale dhe angazhimin e pa kursyer gjatë këtij trajnimi. Ndërsa, komandanti i BRSH-së, gjenerali Hadërgjonaj, u shprehu mirënjohje të gjithë pjesëmarrësve të këtij trajnimi, gjithashtu ka përgëzuar instruktorët e trajnimit për angazhimin dhe realizimin e planit të trajnimit „Njësia për Siguri Fizike“. Ky trajnim ka filluar nga data 10 qershor 2019 dhe ka përfunduar më 28 qershor 2019. Trajnimi është realizuar në dy faza, sepse pjesëmarrësit në trajnim kanë qenë të ndarë në dy grupe

FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 82 • 13 Gusht 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama u takuan me komandantin suprem të NATO-s, gjeneralin Tod Wolters

Prishtinë, 18 korrik 2019 - Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në takime të ndara takuan komandantin suprem të Forcave Aleate për Evropë, gjeneralin Tod Wolters.

Në takim, ministri Berisha e informoi gjeneralin Wolters për Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe implementimin e tij në bashkëpunim të ngushtë me aleatët. Gjithashtu, Ministri theks të veçantë i kushtoi progresit të arritur gjatë 120 ditëve të para të tranzicionit. Ai u shpreh në takim se Forca e Sigurisë së Kosovës edhe me mandatin e ri do të vazhdojë të ndërtohet si forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme.





Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama gjatë takimit me Komandantin Suprem të NATO-s, gjeneralin Tod Wolters, e njoftoi me zhvillimet e FSK-së, të arriturat e përgjithshme si dhe sfidat. Gjenerali Rrahman Rama me gjeneralin Tod Wolters biseduan edhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet NATO-s dhe FSK-së, për zhvillimin e një force profesionale me standarde të NATO-s.

Komandanti Suprem i NATO-s për Evropë, gjenerali Wolters falënderoi ministrin Berisha dhe komandantin Rama për takimin, për përkrahjen e vazhdueshme të KFOR-it në zbatimin e misionit të tij në Kosovë, si dhe përsëriti zotimin e NATO-s dhe KFOR-it për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtnant Rrahman Rama pritet me ceremoni ushtarake në Jordani



Jordani, 25 korrik 2019 - Komandanti i FSK-se, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Jordanisë, gjenerallejtënant Mahmoud Frihat, nga data 22 korrik po qëndron për herë të parë në vizitë zyrtare në Jordani.

Vizita e Komandantit të FSK-së filloi me pritjen ceremoniale të organizuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Jordanisë dhe vazhdoi me takime në mes të dy delegacioneve ku gjenerali Rrahman Rama e njoftoi gjeneralin Frihat dhe delegacionin e tij, për të arriturat e FSK-së dhe procesin e tranzicionit. Në takime janë zhvilluar diskutime lidhur me identifikimin e fushave të përbashkëta të bashkëpunimit në të ardhmen dhe pritet edhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të dy forcave. Gjeneral Rama së bashku me delegacionin e tij i përberë nga koloneli Agron Bajrami, shef i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MM, koloneli Bekim Osmani, atasheu ushtarak i FSK-së në Turqi dhe kapiteni Jaser Mulla, asistent ushtarak i Gjeneral Ramës, patën mundësinë të vizitojnë Qendrën Trajnuese të Forcave Speciale, Qendrën Trajnuese për Mbrojtje Kimike Atomike Biologjike, Forcat Ajrore të Jordanisë, si dhe Byron për Dizajnim dhe Zhvillim e cila funksionon nën ombrellën e Forcave të Armatosura të Jordanisë.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama shprehu falënderimin për mikpritjen e jashtëzakonshme të gjeneral Frihat dhe stafit të tij, si dhe shfrytëzoi rastin që ta ftojë atë dhe delegacionin e tij për një vizitë zyrtare në Kosovë.

FSK-ja mori pjesë në ushtrimin e përbashkët me partnerë ndërkombëtarë në Gjermani

Gjermani, 1 korrik 2019 - Forca e Sigurisë së Kosovës, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me partnerët ndërkombëtarë, është duke marr pjesë në Ushtrimin e Përbashkët KFOR 26, në Hohenfels të Republikës Federale të Gjermanisë.

Ky ushtrim që organizohet për çdo vit ka për qëllim përgatitjen e nevojshme të njësive me mision në kuadër të KFOR-it. Kontingjenti i FSK-së në këtë ushtrim po merr pjesë me 12 pjesëtarë me detyra të specifikuara si: Shtabi i FSK-së, Njësia e EOD-së dhe MKAB-së. Pjesëtarët janë akomoduar në Bazën e Ushtrisë Amerikane në Hohenfels, e cila njëherësh është bazë ku realizohen të gjitha trajnimet ndërkombëtare më fokus të veçantë Evropën.


Ushtrimi po zhvillohet në pesë faza: Arritja, Zbarkimi, Trajnimi, Ushtrimi dhe Rigjenerimi. Tani është duke u zhvilluar faza e tretë, ku njësitë e FSK-së deri më tani kanë marrë pjesë në stërvitjet e organizuara nga homologët e njësive përkatëse kryesisht të ushtrisë amerikane (Stërvitje për njësitë e EOD-së dhe MKAB-së), ku nëpërmjet skenarëve kanë kryer të gjitha koordinimet dhe përgatitjet me qëllim që njësitë të jenë të gatshme për përmbushjen e misionit gjatë ekzekutimit



të ushtrimit. Kontingjenti i FSK-së përveç stërvitjeve në deminim dhe dekontaminim është duke dhënë kontribut të veçantë edhe në fushën e informimit. Në këtë ushtrim të përbashkët njësitet përmes KFOR-it përgatiten për mision real në Kosovë. Pjesëmarrës në këtë ushtrim janë nga: SHBA-ja, Shqipëria, Italia, Sllovenia, Romania, Armenia, Moldavia, Lituania.

Ushtrimi i Përbashkët KFOR 26 ka filluar të zhvillohet më 20 qershor 2019, me zbarkimin e kontingjentit të FSK-së në Hohenfels dhe do të përfundojë më 11 korrik 2019, ku pjesëtarët tanë do të kthehen në Kosovë.

Në Ministrinë e Mbrojtjes u mbajt konferenca „Lansimi i Planit të Integritetit 2019-2022”



Prishtinë, 17 korrik 2019 - Në Ministri të Mbrojtjes u mbajt konferenca „Lansimi i Planit të Integritetit 2019-2022“, ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, zv. ministri Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, UD Sekretar i Përgjithshëm Faruk Geci, drejtori i NALT-it, gjenerali Michael Oberneyer, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad, Svein Eriksen këshilltar i lartë i Qendrës së Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) nga Ministria e Mbrojtjes të Norvegjisë, Shaip Havolli drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, anëtarë të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, atashe ushtarakë, gjeneralë të FSK-së, oficerë dhe zyrtarë të NALT-it, përfaqësues të shoqërisë civile, oficerë të FSK-së dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e hapjes së Konferencës “Lansimi i Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes”, Faruk Geci, U.D Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, foli për rëndësinë e këtij plani ku ndër të tjera theksoi: „Një ndër mekanizmat e nevojshëm, krahas mekanizmave tjerë për funksionim dhe kontroll të brendshëm, padyshim ka qenë themelimi i mekanizmit për avancim të integritetit në institucionin tonë“.

Në Konferencën “Lansimi i Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes”, ministri Rrustem Berisha duke folur në kontekst më të gjerë institucional dhe shtetëror, ndër të tjera tha „Ky plan është derivat i politikave të Ministrisë së Mbrojtjes në funksion të fuqizimit dhe zhvillimi të mëtutjeshëm të institucionit tonë, komfor misionit të ri. Plani i Integritetit zë vend të rëndësishëm në kuadër të dokumenteve strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe është në përputhje me Strategjinë Kundër Korrupsionit në nivel të shtetit. Integriteti është një vlerë që duhet të mishërohet në punën tonë ditore. Integriteti ngërthen angazhimin individual dhe institucional, në funksion të kryerjes së detyrave në përputhje me konceptin e sundimit të ligjit. Plani si i tillë parasheh masa konkrete në drejtim të përmirësimit dhe fuqizimit të segmenteve të rëndësishme, në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në nivel të Forcës. Është e rëndësishme që realizimi i këtyre masave ta avancojë menaxhimin e burimeve njerëzore, prokurimit, financave, kontrollit të brendshëm dhe të aseteve”.

Ndërsa, ambasadori i Norvegjisë në Republikën e Kosovës, z. Per Strand Sjaastad, në fjalën e tij ndër të tjera tha: „Zbatimi i ligjit në rend të parë është detyrim. Kosova në vazhdimësi ka bërë përpjekje të mëdha për luftimin e kësaj dukurie, por ju sugjeroj që duhet organizuar plane strategjike më të shpeshta siç është kjo për luftimin e korrupsionit. Dihet edhe nga përvojat paraprake që luftimi i korrupsionit sjellë në vete edhe rreziqe, por kjo nuk do të thotë që duhet ndaluar së luftuari atë. Mbi këtë çështje, për luftimin e kësaj dukurie negative duhet punuar fuqishëm dhe bashkërisht“. Po ashtu debatit me diskutimet e tyre i kontribuuan edhe drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, z. Shaip Havolli dhe Svein Eriksen, këshilltar i lartë i Qendrës së Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) nga Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë.

Ministri i Mbrojtjes Berisha priti në takim lamtumirës ambasadorin e Kanadasë



Prishtinë, 1 korrik 2019 - Ministri i Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha, priti sot në takim lamtumirës ambasadorin jo rezident të Kanadasë në Republikën e Kosovë, z. Daniel Maksymiuk. Ministri Berisha e falënderoi Ambasadorin Maksymiuk për përkrahjen dhe bashkëpunimin e jashtëzakonshëm me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në gjatë mandatit të tij. Më pas Ministri e njoftoi ambasadorin për progresin e arritur në zbatimin e Planit Gjithëpërfshirës së Tranzicionit të FSK-së gjatë fazës së parë 120 dhiteshe si dhe sfidat të cilat janë duke u adresuar në bashkëpunim me aleatët.

Ministri Berisha e ritheksoi se objektiv strategjik i Republikës së Kosovës është anëtarësimi në NATO dhe kontributi, përmes FSK-së, në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në botë. Ministri i Mbrojtjes shprehu konsideratë të lartë për përkrahjen gjithëpërfshirëse të Kanadasë për popullin dhe shtetin e Kosovës, duke përfshirë edhe shërbimin e 4,500 pjesëtarëve të Ushtrisë së Kanadasë, në kuadër të KFOR-it, për ruajtjen e stabilitetit dhe paqes në Kosovë e rajon.

Ambasadori Maksymiuk e çmoi lart bashkëpunimin e shkëlqyer me ministrin Berisha dhe qasjen e hapur dhe transparente gjatë gjithë procesit të zhvillimeve të rëndësishme në Ministri dhe FSK. Ai u shpreh i mahnitur me sukseset e Ministrisë në zhvillimin e FSK-së si një forcë profesionale, të besueshme dhe shumetnike.

Duke vlerësuar aspiratat e Republikës së Kosovës për anëtarësim në NATO, ambasadori Maksymiuk tha se shpreson që një ditë trupat kanadeze, krah për krah me pjesëtarët e FSK-së, do të kontribuojnë së bashku për paqe dhe siguri. Ai më tutje konfirmoi se është në interes të Kanadasë që ta vazhdojë edhe më tej angazhimin në Kosovë dhe ta thellojë edhe më tej bashkëpunimin me vendin tonë dhe rajonin. Ambasadori Maksymiuk nënvizoi se ka vendosur që pikërisht në Kosovë ta festojë sot Ditën Kombëtare të Kanadasë bashkë me ushtarët kanadezë.

Ministri i Mbrojtjes dhe kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës formalizojnë bashkëpunimin në mes FSK-së dhe KOK-ut



Prishtinë, 2 korrik 2019 - Ministri i Mbrojtjes me bashkëpunëtorë priti sot në takim pune Presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), z. Besim Hasani, dhe Sekretarin z. Shasivar Haxhiaj.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh i nderuar për këtë takim dhe përgëzoi Presidentin Hasani për sukseset e sportistëve kosovarë, të cilët na bëjnë krenarë të gjithëve. Ministri me këtë rast i informoi zyrtarët e KOK-ut rreth procesit të tranzicionit të FSK-së dhe të arriturave gjatë fazës së parë 120 ditësh pas miratimit të ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Në takim u diskutua rreth formalizmit të bashkëpunimit të KOK-ut me FSK-në në fushën e sportit. Kjo do të ndikonte edhe në masivizimin e sportit te të rinjtë e vendit tonë.

Presidenti Hasani shprehu gatishmërinë që KOK-u ta përkrahë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në organizimin e pjesëtarëve të FSK-së nëpër klube në disiplina të ndryshme sportive, organizimin e garave si dhe në themelimin e federatës ushtarake të sporteve brenda FSK-së. FSK-ja në radhët e saj ka sportistë të përgatitur, të cilët me sukses mund të garojnë në gara ndërkombëtare. Duke ndjekur praktikat e mira të disa ushtrive në Evropë, Presidenti Hasani propozoi që disa prej sportistëve elitarë të Kosovës t’u mundësohet që të bëhen pjesëtarë të FSK-së. Ministri Berisha e përkrahu këtë ide dhe u zotua që do të hulumtohen modalitet më të përshtatshme që sportistët elitarë ta nderojnë FSK-në si pjesëtarë në uniformë, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi.

Ministri Berisha dhe presidenti i KOK-ut z. Hasani u pajtuan që pa vonesë të themelohen grupet punuese nga të dy palët për ta hartuar një memorandum bashkëpunimi me qëllim të thellimit të bashkëpunimit institucional midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komitetit Olimpik të Kosovës.

Në Ministri nënshkruhet dorëzim-pranimi i Aeroportit të Gjakovës

Aeroporti i Gjakovës kalon në shfrytëzim të FSK-së

Prishtinë, 16 korrik 2019 - Sot, në Ministrinë e Mbrojtjes u mbajt ceremonia e dorëzim–pranimit të Aeroportit të Gjakovës, për nevojat e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Në ceremoni morën pjesë dy komisionet përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Zhvillimit ekonomik. Kohë më parë, me vendim të Qeverisë së Kosovës, nr. 14/98, datë 18.04.2019, është aprovuar kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes për marrjen në shfrytëzim, me kohë të pacaktuar të Ndërmarrjes publike „Aeroporti i Gjakovës“ për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Komisionet e të dyja Ministrive pas vlerësimit dhe regjistrimit të pajisjeve brenda hapësirës të Aeroportit, kanë kompletuar dokumentacionin përkatës dhe përcjelljen e të gjitha procedurave për dorëzim-pranimin e Aeroportit. Nënshkrimin e dorëzim–pranimit të Aeroportit të Gjakovës, në prezencën e të dyja komisioneve e bënë; Filloreta Gashi, kryesuese e Komisionit të MZHE, dhe nënkoloneli Mentor Zejnullahu, drejtor i Drejtorisë të Logjistikës në Ministri të Mbrojtjes.

Nga momenti i nënshkrimit të këtij procesverbali, respektivisht të pranim dorëzimit nga të dyja komisionet, NP „Aeroporti i Gjakovës“ kalon në menaxhim dhe administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma “Adem Jashari”, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ambasadori i Gjermanis vizitoi Kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë

Ministri Berisha: Gjermania po e mbështet FSK-në në të gjitha fushat



Prishtinë, 05 korrik 2019 - Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi pritën në ambientet e Kazermës „Adem Jashari“ në Prishtinë ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, z. Christian Heldt.

Gjatë takimit me ambasadorin e Gjermanisë u tha se mbështetja gjermane nuk ka munguar asnjëherë për Kosovën, po në veçanti për FSK-në. Republika Federale e Gjermanisë e ka mbështetur në të gjitha fushat FSK-në, si me donacione, trajnime, mbështetje të cilat kanë mundësuar që FSK-ja të jetë forcë operacionale dhe e gatshme për të mbështetur popullatën e Kosovës.

Qëllimi i kësaj vizite ishte certifikimi i oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së, në Kursin bazik të gjuhës gjermane, që është financim i ambasadës Gjermane në Kosovë. Ministri Berisha, me këtë rast, theksoi se shteti Gjerman është një shtet mik dhe strategjik për Kosovën. Ai falënderoi ambasadorin për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Gjermania Kosovës në kohët më të vështira dhe po i jep edhe sot në ngritjen e kuadrove të FSK-së në aspektin profesional e akademik, në mbështetje të vazhdueshme teknike e donacione të rëndësishme. “Ne ju jemi mirënjohës për këto që po bëni për Kosovën e në veçanti FSK-në. Unë si ministër kam pas fatin të bashkëpunoj me të gjithë gjeneralët gjermanë në NALT, të cilët kanë lënë gjurmë në krijimin e FSK-së, avancimin dhe mbështetjen e pakursyer që ata kanë dhënë për ne” tha Ministi Berisha. Me këtë rast Ministri Berisha iu uroj kursantëve punë të mbarë dhe avancimin e tyre në kurse tjera që Republika Federale Gjermane ofron për FSK-në.

Ndërsa, ambasadori gjerman, z. Christian Heldt e nisi fjalën me një shprehje popullore „Në futboll është shprehja para lojës dhe pas lojës“, për të vazhduar: ”Me Gjermaninë nuk ka përfunduar gjithçka, ne jemi vetëm duke vazhduar mbështetjen për ju, dhe këtë e bëjmë që ju të jeni të integruar në ushtrinë gjermane dhe të jeni pjesë e trajnimeve që ne ofrojmë për FSK-në, dhe shpresoj që ky investim është një e mirë për ju që në vitet e ardhshme të tranzicionit do ju ndihmojë që ecja juaj drejt integrimeve euroatlantike të jetë më e lehtë me vendet anëtare”. Në këtë aktivitet u ndanë certifikatat për kursantët e nivelit bazik të gjuhës gjermane.

Ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama dekorojnë këshilltarin ushtarak kolonelin Hakan Duman





Prishtinë, 05 korrik 2019 - Sot në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës u organizua një takim lamtumirës për kolonelin Hakan Duman, këshilltarin ushtarak të ministrit Rrustem Berisha dhe komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës.

Ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, me këtë rast e kanë falënderuar kolonelin Duman për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm si dhe për përkrahjen e jashtëzakonshme të dhënë për Ministrinë dhe FSK-në, gjatë mandatit të tij, në kuadër të FSK-së. Gjithashtu, ministri Berisha dhe gjeneral Rama, kolonelin Duman e kanë dekoruar me Mirënjohje dhe Medalje për „Shërbim vetëmohues“ gjatë kohës, sa ka shërbyer si këshilltar i Ministrit dhe Komandantit, ndërsa, pasardhësit të tij, kolonelit Erhan Bahatir i kanë dëshiruar mirëseardhje dhe njëherësh i kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim gjatë mandatit të tij, si këshilltar ushtarak për Ministrin dhe komandantin e FSK-së.

Koloneli Hakan Duman, me këtë rast, e ka falënderuar ministrin Berisha dhe gjeneral Ramën, për bashkëpunimin e mirë që ka pasur gjatë mandatit të tij, si dhe ka uruar suksese të reja për FSK-në. Në takimin lamtumirës ishte prezent edhe drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Michael Oberneyer, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së, dhe të NALT-it, si dhe zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes.

Sot në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës u organizua një takim lamtumirës për kolonelin Hakan Duman, këshilltarin ushtarak të ministrit Rrustem Berisha dhe komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës.

Ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, me këtë rast e kanë falënderuar kolonelin Duman për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm si dhe për përkrahjen e jashtëzakonshme të dhënë për Ministrinë dhe FSK-në, gjatë mandatit të tij, në kuadër të FSK-së. Gjithashtu, ministri Berisha dhe gjeneral Rama, kolonelin Duman e kanë dekoruar me Mirënjohje dhe Medalje për „Shërbim vetëmohues“ gjatë kohës, sa ka shërbyer si këshilltar i Ministrit dhe Komandantit, ndërsa, pasardhësit të tij, kolonelit Erhan Bahatir i kanë dëshiruar mirëseardhje dhe njëherësh i kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim gjatë mandatit të tij, si këshilltar ushtarak për Ministrin dhe komandantin e FSK-së.

Koloneli Hakan Duman, me këtë rast, e ka falënderuar ministrin Berisha dhe gjeneral Ramën, për bashkëpunimin e mirë që ka pasur gjatë mandatit të tij, si dhe ka uruar suksese të reja për FSK-në. Në takimin lamtumirës ishte prezent edhe drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Michael Oberneyer, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së, dhe të NALT-it, si dhe zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në Ministrinë e Mbrojtjes u mbajt sesioni i II-të për Komunikim Strategjik

Prishtinë, 09 korrik 2019 - Sot në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u mbajt sesioni i II-të, i Komitetit Ndërministror për Integrim dhe anëtarësim në NATO. Në takimin e sesionit të II-të morën pjesë: Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, zv. ministri i Mbrojtjes Burim Ramadani, i cili është edhe koordinator i Komitetit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim të Kosovës në NATO, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, këshilltarja për Komunikim Strategjik në NALT për Ministrinë e Mbrojtjes, znj. Nicolien Wellen, zëdhënësi i KFOR-it, koloneli Vicenco Grasso si dhe përfaqësues të personelit të Zyrës së Kryeministrisë dhe zyrave të informimit të ministrive të Republikës së Kosovës, që janë pjesë e Komitetit ndërministrorë.

Zv. ministri Ramadani bëri hapjen e punimeve të sesionit të II-të të Komunikimit Strategjik të Komitetit Ndërministror për Integrim dhe Anëtarësim në NATO. Në fjalën e tij ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha foli për të arriturat e përgjithshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në veçanti për Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së, i cili do të zbatohet gradualisht në tri faza gjatë dhjetë viteve të ardhshme, deri në arritjen e kapaciteteve të plota operacionale.

Ministri Berisha me këtë rast falënderoi të gjithë ata që



kanë kontribuar në këtë drejtim duke shtuar: “tranzicioni do të bëhet në koordinim të plotë me partnerët strategjikë të Republikës së Kosovës, NATO-n, KFOR-n, SHBA-të. Të gjitha arritjet e deritashme janë storie e përbashkët edhe e ndërkombëtarëve me KFOR-in, NATO-n, NALT-in“.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama i njoftoi pjesëmarrësit për sukseset dhe sfidat e deritashme të FSK-së. Ai në fjalën e tij tha: „Transparenca dhe sinqeriteti me partnerët tanë strategjikë, NATO-n, KFOR-in, NALT-in, është e rëndësishme në arritjet e përgjithshme të FSK-së. Për ne prioritet mbetet zhvillimi i komunikimit strategjik, që është shumë i rëndësishëm për bashkëpunimin me NATO-n, aty ku është edhe synimi ynë për anëtarësim”.

Punimet e sesionit i ndihmuan edhe zonja Nikcolien Wallen, këshilltare për Komunikim Strategjik në NALT dhe zëdhënësi i KFOR-it, koloneli Vicenco Grasso, që folën për bashkëpunimin me institucionet e Kosovës, si dhe për përvojën e tyre në komunikimin strategjik. Koloneli Haki Hoti, drejtor i Departamentit të Transformimit të Ministrisë së Mbrojtjes foli për temën: “FSK-ja, dje dhe sot”.

Kadetët e FSK-së përfunduan me sukses ushtrimin ndërkombëtar „Kampi Veror 2019“ në Maqedoni të Veriut



Maqedoni-Krivollakë, 26 korrik 2019 - Me stërvitjen taktike në poligonin ushtarak në Krivollak të Maqedonisë së Veriut, kadetët e akademive ushtarake të 12 shteteve pjesëmarrës përfunduan me sukses ushtrimin fushor „Kampi Veror 2019“. Në këtë ushtrim krahas kadetëve të SHBA-ve, Shqipërisë, Gjermanisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës Çeke, Bullgarisë, Kroacisë, Malit të Zi, Norvegjisë, Maqedonisë së Veriut morën pjesë edhe kadetët e FSK-së, të cilët demonstruan me sukses aftësitë e tyre profesionale si dhe nivelin e gatishmërisë të fituara gjatë studimeve në QSU.

Ditën kryesore të ushtrimit fushor „Kampi Veror 2019“ ushtrimin e përcolli nga afër gjeneral brigade Irfete Spahiu, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe oficerë të lartët të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së. Kadetët e FSK-së edhe këtë vit u dalluan me paraqitjen e tyre të shkëlqyeshme si në operacionet individuale dhe ato kolektive. Në përmbyllje të ushtrimit, gjeneral Spahiu, ka përgëzuar të gjithë kadetët e FSK-së, për pjesëmarrje në ushtrimin fushor si dhe për profesionalizmin, disiplinën dhe ndërveprimin e e realizuar me kadetët e shteteve pjesëmarrëse. Ushtrimi fushor „Kampi veror 2019“ ka karakter ndërkombëtar dhe organizohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe Akademia Ushtarake e Maqedonisë së Veriut, në të cilin për çdo vit po marrin pjesë kadetët e vende të ndryshme të rajonit e më gjerë, të menaxhuar nga instruktorë të NATO-s dhe të Partneritetit për Paqe.





Bashkëpunim i shkëlqyeshëm në mes EOD-së të FSK dhe KFOR-it amerikan



Prizren, 17 korrik 2019 - Në Kazermën e Kompanisë së Deminimit të FSK-së „Lidhja e Prizrenit“ në Prizren, u organizua pritje me rastin e përfundimit të mandatit të Kontingjentit të KFOR 25 - EOD nga SHBA-të, të Kampit Bondstel, si dhe ardhjes së kontingjentit të KFOR 26-EOD, të cilët ishin së bashku edhe në ushtrimin e përbashkët në Gjermani me Kontingjentin e EOD-së të FSK-së.

Komandanti i Kompanisë së Deminimit, majori Gëzim Sada, në emër të komandantit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonelit Shaip Haziri dhe në emrin e tij, ka falënderuar EOD-në e SHBA-ve për mbështetjen e jashtëzakonshme të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, si dhe bashkëpunimit dhe koordinimit gjatë realizimit të detyrave të përbashkëta me EOD-në e SHBA-ve. Major Sada, tha se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen me kontingjentet tjera që do të vijnë në Kosovë. Ndërsa, toger Martin Taylor, falënderoi komandantin dhe Kompaninë e Deminimit për mirëpritjen, bashkëpunimin, bashkërendimin dhe mbështetjet, që janë bërë gjatë nëntë muajve të kaluar.

Komandanti i Kompanisë së Deminimit, majori Gëzim Sada pjesëtarëve të EOD-së, të SHBA-ve që kanë përfunduar misionin e tyre në Kosovë u dha mirënjohje për punën e shkëlqyer dhe bashkëpunimin në misionin e tyre të ruajtjes së paqes dhe sigurisë në Kosovë.

Libra për FSK-në

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes nga Shqipëria i dhuroi mbi 35 000 libra Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Kosovës

Ferizaj, 19 korrik 2019 - Në kazermën „Skënderbeu“ të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e dorëzim-pranimit të literaturës ushtarake nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët i dhuruan FSK-së mbi 35.000 copë libra, me mbi 1500 tituj. Komandanti i KDS-FSK-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu e priti delegacioni nga KDS-FARSH të udhëhequr nga koloneli Riza Zaja - shef i



Shtabit të KDS-FARSH.
Në fjalën e rastit gjeneral Spahiu e falënderoi FARSH-në për kontributin dhe ndihmën e dhënë Bibliotekës dhe sektorit të Doktrinës së KDS-së. Ajo ndër të tjera tha “kjo është një ngjarje me rëndësi të madhe për Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, pasi e veçanta e kësaj ceremonie është se librat janë shumë të çmuar dhe se ato janë dhuratë nga Ushtria e Shtetit Shqiptar”.

Ndërsa, në emër të KDS-FARSH-së, koloneli Riza Zaja, ndër të tjera, tha: „KDS-ja e Shqipërisë është e nderuar që ka mundësi të ndihmojë KDS-në e Kosovës, dhe se me këtë rast po thellohet bashkëpunimi i mirë ndërmjet dy KDS-ve dhe se ky aktivitet nuk do të jetë i fundit ndërmjet tyre”.

Literatura kryesisht është me tematikë ushtarake që do të shfrytëzohet nga i gjithë personeli i KDS-së dhe FSK-së.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i dhuroi FSK-së 135 tituj të rinj të librave




Prishtinë, 22 korrik 2019 - Bibliotekës së Forcës së Sigurisë të Kosovës në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë, iu shtuan sot edhe 135 tituj të rinj të librave në gjuhën shqipe të cilët u dhuruan nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Për ta dorëzuar këtë donacion në ekzemplarë në FSK kishte ardhur ministri i MKRS-së, z. Kujtim Gashi i cili u mirëprit nga zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore koloneli Hasan Hoxha dhe komandanti i Njësisë për Reagim në Kriza, nënkoloneli Milaim Musliu.

Gjeneral Cikaqi e falënderoi ministrin Gashi për ekzemplarët e librave që i dhuroi sot, të cilët siç tha ai do ta begatojnë edhe më shumë Bibliotekën e FSK-së.

Ministri Gashi u shpreh i kënaqur për dhurimin e këtyre librave, duke thënë se ky nuk do të jetë donacioni i fundit për këtë bibliotekë. „Donacioni që po e dorëzojmë sot është tejet cilësor. Këta libra janë librat më të mirë që janë botuar gjatë vitit 2018, andaj jam shumë i kënaqur që këta tituj po ia dhurojmë FSK-së. Ne nuk do të ndalemi vetëm më këtë donacion, por do vazhdojmë edhe në të ardhmen më donacione të tilla për këtë bibliotekë”, u shpreh ndër të tjera ministri Gashi. Nënkolonel Musliu dhe përgjegjësja e Bibliotekës, tetar Samire Tahiraj e njoftuan në pika të shkurtra ministrin Gashi për historikun e Bibliotekës së FSK-së, donacionet e dhuruara deri më tani, mënyrën e shfrytëzimit të librave të bibliotekës nga pjesëtarët e FSK-së, si dhe për vizitat e shumta të cilat i bëhen kësaj biblioteke.

Biblioteka e FSK-së çdo ditë e më shumë po pasurohet me tituj të ndryshëm të librave si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze, në mënyrë që pjesëtarët e saj të kenë mundësi të jenë sa më afër librit.

Kadetë të Universitetit Norwich-it nga Vermonti i SHBA-ve vizituan FSK-në



Prishtinë, 15 korrik 2019 - Në kuadër të qëndrimit dyditor, sot në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes, një grup i kadetëve të Universitetit të Norwich-it të Shteteve të Bashkuara të Amerikës vizituan vizituan Ministrinë e Mbrojtjes dhe Qendrën për Studime Universitare të FSK-së. Gjatë ditës së sotme, studentët amerikanë, në Ministrinë Mbrojtjes u pritën nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe stafi i lartë i FSK-së, të prirë nga koloneli Agron Bajrami, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë e Mbrojtjes.

Qëllimi i vizitës së kadetëve amerikanë është realizimi i një vizite akademike në institucionet e mbrojtjes të Republikës së Kosovës. Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me profesorin e Universitetit të Norvich-it, Dr. Travis Morries, biseduan për bashkëpunimin e dyanshëm në mes Universitetit të Norvich-it dhe FSK-së, përkatësisht Qendrës për Studime Universitare të FSK-së.

Koloneli Agron Bajrami falënderoi studentët për vizitën si dhe i njoftoi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, dhe sidomos me procesin e tranzicionit në MM dhe FSK. Delegacioni i studentëve amerikanë gjithashtu vizitoi edhe Qendrën për Studime Universitare të FSK-së ku u prit nga majori Vegim Krelani, i cili i njoftoi me të arriturat e përgjithshme të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së.

Certifikohen pjesëtarë të FSK-së, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave në Kursin Bazik të Zhytjes



Pomozotin, 12 korrik 2019 - Në Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, sot u mbajt ceremonia e certifikimit në Kursin bazik të zhytjes. Në kurs morën pjesë 23 pjesëtarë nga FSK-ja, Policia e Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Ky trajnim ishte vazhdimësi e trajnimit të mbijetesë në ujëra, i cili u realizuar për tri javë rresht, duke realizuar temat: teknikat e notit, zhytja e lirë, shpëtimi i personave të përmbytur e në veçanti përdorimi i aparatit të zhytjes. Në ceremoni morën pjesë: Komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale, gjenerali Naim Haziri, zv. drejtori i AME-së, Shefki Abdullahu, togeri Lutfi Ukiqi, nga Policia e Kosovës, shefi i Shtabit të RMC-së, nënkoloneli Bajram Bekteshi, oficerë dhe zyrtarë nga FSK-ja, Policia e Kosovës dhe AME-ja.

Gjenerali Naim Haziri me këtë rast tha; „Objektiv i Komandantit të FSK-së ka qenë ngritja e kapaciteteve trajnuese për FSK-në, por edhe ngritja e kapaciteteve trajnuese për institucionet vendore të sigurisë dhe ato regjionale. Prandaj, me plotë bindje e them sot se qëllimi i Komandantit të FSK-së është arritur. Kemi ngritur kapacitete trajnuese për fushat e emergjencave, ngritjen e Qendrës Trajnuese të Kërkim-Shpëtimit, e cila ka krijuar mundësi të mira për trajnime, që në të ardhmen të jemi bashkërisht në operacione kurdo që kërkohet“.

Ndërsa, zv. drejtori AME-së, Shefki Abdullahu u shpreh i kënaqur me të arriturat gjatë këtij trajnimi. „Institucionet tona për çdo ditë janë më të koordinuara në aspektin e ndërveprimit dhe po punojnë bashkërisht bazuar në detyrat dhe misionin e tyre. Kjo është e rëndësishme dhe më gëzon fakti që po punojmë në krijimin e një reagimi të përbashkët me të gjitha institucionet e sigurisë në vend“.

Togeri Lutfi Ukiqi falënderoi FSK-në për bashkëpunimin dhe e vlerësoi lartë punën dhe angazhimin e përbashkët për ngritjen profesionale të pjesëtarëve të të gjitha institucioneve. Shefi i Qendrës së Kërkim-Shpëtimit, John Doon, foli për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional: „Vet prezenca tregon edhe rëndësinë e trajnimit, ku të tri institucionet janë bashkuara në një trajnim të përbashkët. Kjo është një e arritur e madhe për Qendrën tonë“.

Në fund të ceremonisë u ndanë certifikata për pjesëmarrësit në trajnim.

Nënkolonel Ejup Maqedonci ka përfunduar me sukses të lartë Kolegjin e Luftës në SHBA



SHBA, 26 korrik 2019- Kolegji i Luftës është institucion edukativ i Ushtrisë Amerikane në Pensilvani që përgatitë oficerët e lartë ushtarakë dhe zyrtarët e tjerë të institucioneve të sigurisë për marrjen e përgjegjësive të lidershipit në nivel strategjik në institucione ushtarake dhe të sigurisë. Kolegji i Luftës është i akreditуar nga Komisioni i edukimit të lartë të SHBA-ve (Commission on Higher Education of the Middle States Association of Colleges and Schools),i cili përveç programit të edukimit profesional ushtarak ofron dhe mundësi për ndjekjen e nivelit të studimeve Master në fushën strategjike. Gjatë studimeve në Kolegjin e Luftës përpos përfundimit të programit të Kolegjit të Luftës nënkolonel Maqedonci ka përfunduar edhe programin Master të Studimeve Strategjike dhe ka marrë Diplomën e Kolegjit dhe Diplomën e Masterit të Studimeve Strategjike. Nga Kolegji i Luftës, bazuar në rezultatet dhe performancën e treguar, nënkolonel Maqedonci ka marrë titullin "Student Superior", i cili nënkupton klasifikimin e tij në mesin e studentëve më të mirë të vitit akademik 2019. Në vitin akademik 2019, Kolegjin e Luftës e kanë ndjekur 280 studentë amerikanë dhe 76 oficerë ndërkombëtarë nga 74 vende të ndryshme të botës. Përveç angazhimit rreth programit akademik në Kolegjin e Luftës, nënkolonel Ejup Maqedonci është zgjedhur edhe anëtar i panelit në aktivitetin "Kosova – 20 vite pas", që kishte për qëllim shënimin e 20- vjetorit të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë, ku disa herë është ftuar nga instruktorët e ndryshëm që të asistojë në ligjëratat e tyre në lëndët zgjedhore që kishin fokus çështjet gjeostrategjike dhe të sigurisë në Evropën Jug-lindore.

Gjatë studimeve nënkoloneli Maqedonci ka përfaqësuar denjësisht vendin dhe institucionin e FSK-së në shumë aktivitete, si në aktivitetin "Know Your World" (Njihni botën tuaj), ku së bashku me familjen ka prezantuar veshjet tradicionale, ushqimet dhe traditat e vendit dhe popullit tonë. Vlen të ceket se për programin Master, nënkolonel Ejup Maqedonci ka përgatitur punimin "Kosova: Sfidat e Sigurisë dhe Strategjia e Madhe" (Kosovo: Security Challenges and the Grand Strategy).

28 pjesëtarë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së certifikohen në seminarin për Logjistikë

Prishtinë, 04 korrik 22019 - Në Ministrinë e Mbrojtjes nga data 01-05 korrik 2019 është zhvilluar seminari me titullin: "Logjistika dhe Menaxhimi i Ciklit Jetësor (Logistics and Life Cycle Menagement)", në të cilin morën pjesë 28 zyrtarë të stafit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të FSK-së, niveli i mesëm dhe i lartë. Seminari u mbajt në bashkëpunim me ODC (Zyra për Bashkëpunim e Ambasadës amerikane në Prishtinë) nga Instituti për Qeverisje të Sigurisë, Programi Ndërkombëtar për Menaxhim të Resurseve për Blerje në Fushën e



Mbrojtjes (IDARM), ku ligjëruan instruktorët amerikanë: Dr. Patrick Gambrel dhe koloneli në pension Raymond Jones.

Në kurs u prezantuan komponentët kryesorë dhe karakteristikat e menaxhimit efektiv të logjistikës, roli i planifikimit të logjistikës dhe ciklit jetësor, në procesin e blerjeve dhe vendimmarrjes logjistike në fushën e mbrojtjes.

Gjatë seminarit, pjesëmarrësit diskutuan edhe praktikat në menaxhimin e logjistikës në grupe, duke u bazuar kryesisht në zbatimin e praktikave, koncepteve dhe të metodave të mësuara gjatë seminarit. Në ceremoninë e certifikimit mori pjesë edhe drejtori i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim në Ministrinë e Mbrojtjes, koloneli Agron Bajrami, i cili falënderoi instruktorët dhe Zyrën për Bashkëpunim të Ambasadës amerikane në Prishtinë.

Trajnerët e deminimit nga Kosova dhe Shqipëria trajnohen nga instruktorët amerikanë

Prizren, 12 korrik 2019 - Sot në Kazermën e Deminimit në Prizren është realizuar ceremonia e certifikimit të 21 kursantëve në trajnimin „TRAJNO TRAJNERËT – EOD- Niveli- 2". Në ceremoni morën pjesë: Komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri, komandanti i Kompanisë së Deminimit, majori Gëzim Sada, përfaqësuesi i NALT-it, nënkoloneli Todd Essing, instruktorë amerikanë dhe përfaqësues të Qendrës Koordinuese për Deminim në Kosovë.

Me këtë rast, koloneli Shaip Hazir falënderoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën e vazhdueshme që po japin për FSK-në. Ai kursantët i porositi që "të jenë vigjilent dhe profesional në kryerjen e detyrave që i presin gjatë operacioneve, pasi që pas përfundimit të luftës pjesëtarët e njësive të deminimit janë çdo ditë me rrezikun në pastrimin e fushave të minuara". Majori Gëzim Sada, në fjalën e tij tha: "Duke pasur parasysh detyrat dhe aktivitetet që kryen Kompania e Deminimit, si dhe rrezikun e paraqitur gjatë kryerjes së detyrave, ky trajnim si dhe të gjitha trajnimet tjera janë më se të mirëseardhura, ngase mënyra më e mirë për të qenë sa më larg rrezikut është: stërvitja, trajnimi dhe shkëmbimi i eksperiencave. Uroj dhe shpresoj që edhe ju do të vazhdoni rrugën e të gjithë atyre të cilët tash e njëzet vite kanë punuar dhe kanë pastruar qindra mijëra metra katrorë, kanë gjetur dhe asgjësuar mijëra mina, mjete të rrezikshme dhe nuk kanë pasur as më të voglin incident apo aksident dhe e gjithë kjo është arritur falë motivit, vullnetit, disiplinës dhe përkushtimit të lart të të gjithë atyre që kanë shërbyer në Kompaninë e Deminimit".



Para kursantëve foli edhe përfaqësuesi i NALT –it, nënkoloneli Todd Essing i cili tha se "ndjehet krenar që „KRAH PËR KRAHU" ka mbështetur pjesëtarët e TMK-së, dhe tani pjesëtarët e FSK-së, në profesionalizimin dhe aftësimin e tyre profesional".

Instruktori amerikan, kapterri Jameson Baehler, falënderoi stafin komandues për përkrahjen në realizimin e këtij trajnimi. Trajnimi "Trajno – Trajnerët e EOD, niveli 2-të" ka zgjatur katër javë duke filluar më 17 qershor dhe përfunduar më 12 korrik 2019.

Në këtë trajnim kanë marrë pjesë njëzet e një pjesëtarë: gjashtëmbëdhjetë nga Kompania e Deminimit të FSK-së, dhe pesë pjesëtarë nga njësiti i EOD-së të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Trajnimi është organizuar në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-ve, kurse ligjëratat i kanë mbajtur instruktorë të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë (EUCOM) Airforce.

Certifikohen 20 oficerë e nënoficerë në kursin „Kërkim-Shpëtim Urban i Avancuar”

Prishtinë, 19 korrik 2019 - Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, sot u mbajt ceremonia e certifikimit të 12 pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe 8 pjesëtarëve nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, të cilët për dy javë kanë ndjekur trajnimin intensiv: „Kërkim-Shpëtimi Urban, niveli i parë i avancuar”, që është vazhdimësi e trajnimit bazik të KSH Urban.



Gjatë këtyre dy javëve janë trajtuar tema të rëndësishme teorike dhe praktike e që të pranishmit kanë pasur rastin të merren me situata po thuaj reale. Në ceremoni të pranishëm ishin: komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale, gjeneral brigade Naim Haziri, KOM RMC, koloneli Shaip Haziri, koloneli Besnik Syla nga Ushtria Shqiptare, drejtori i Zjarrfikësve Miran Demiri, drejtori i QTKSH, John Doone, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së dhe FARSH-së.

Komandanti i BMO-së gjeneral brigade Naim Haziri, fillimisht përcolli përshëndetjet e KOM FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, duke theksuar se Qendra e Kërkim-Shpëtimit, po na bënë krenarë në të gjitha fushat. Në vizitën që kemi pasur në Republikën e Shqipërisë, tha gjeneral brigade Haziri, me Gjeneralin Lala kemi biseduar që kapacitetet dhe asetet e përbashkëta t`i përdorim në të mirë të gjithëve dhe në të ardhmen të veprojmë dhe intervenojmë me këto kapacitete si në Vlorë, në Kosovë dhe ku do në rajone për t`iu dal në ndihmë të gjithë qytetarëve.

Ndërsa, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri, në fjalën e tij, tha: „Qendra trajnuese përgatit personel të aftësuar për t`iu dal në ndihmë qytetarëve. Mua si komandant më gëzon fakti që Qendra Trajnuese i ka kaluar pritjet e mia, pasi që fillimisht kjo qendër ishte krijuar për të përgatitur dhe trajnuar pjesëtarët e FSK-së, por kjo ka kaluar kufijtë e FSK-së dhe tani më në disa gjenerata kemi kursant jo vetëm nga institucione vendore të sigurisë por edhe jashtë vendit, nga Republika e Shqipërisë e vende tjera“.

Koloneli Besnik Syla, nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë pasi falënderoi për mundësinë që ju ka dhënë oficerëve dhe nënoficerëve nga FARSH-ja që të ndjekin trajnimet në QTKSH, tha: „Gjatë këtyre dy viteve ka qenë një bashkëpunim suksesi fal interesit të përbashkët, për të arritur rezultate së bashku me instruktorët dhe kursantët në arritjen e qëllimit të caktuar“.

Drejtori i Zjarrfikësve në AME-së, Miran Demiri tha se më vjen mirë që jemi si një trup i përbashkët agjencionet e Sigurisë së Kosovës dhe Shqipërisë të trajnohen dhe përgatiten në fusha të emergjencave me standarde dhe procedura të njëjta.

Drejtori i Qendrës së Trajnimit të KSH, Jon Dohne, tha ; „Qëllimi im dhe i qendrës është që të përgatisim njerëz dhe qytetarët ta dinë që nëse në të ardhmen ndodh një fatkeqësi, populli ta dijë, që ka njerëz të përgatitur dhe të gatshëm që ata do të t`i shpëtojnë dhe këtij qëllimi ja kemi arritur.“

Deminerët e FSK-së tregojnë përkushtim dhe profesionalizëm të lartë



Prishtinë, 26 korrik 2019 - Ekipet e Kompanisë së Deminmit të FSK-së, çdo ditë janë duke punuar me intensitet të lartë edhe në këto kohë të nxehta të verës. Me punën, përkushtimin dhe profesionalizimin e tyre janë duke bërë një punë të madhe në pastrimin dhe eliminimin e mjeteve të pashpërthyera, të cilat gjenden në fusha të minuara si pasojë e luftës në Kosovë. Kompania e Deminimit gjatë këtij viti (2019), ka intervenuar në 212 thirrje për detyra të EOD-së dhe ka pastruar 43535 metra katrorë, që janë dyshuar si sipërfaqe të rrezikshme dhe kanë shkatërruar 358 mjete të pashpërthyera eksplozive. Ekipet e Kompanisë së Deminimit janë duke punuar në pastrimin dhe eliminimin e mjeteve të pashpërthyera eksplozive në 4 lokacione të ndryshme në Kosovë: në Babaj të Bokës–Gjakovë, Seçishtë –Han i Elezit, Parku i Lirisë dhe Hapësira e Kazermës së FSK-së në Ferizaj.

Ekipet e deminimit në terren i ka vizituar komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), koloneli Shaip Haziri dhe komandanti i Kompanisë së Deminimit majori Gëzim Sada. Kolonel Haziri, pasi u njoftua nga afër me punën e deminerëve rreth pastrimit të fushave të rrezikshme, i përgëzoi deminierët për punën profesionale dhe humane që janë duke bërë që nga paslufta e deri më tani. Falë profesionalizmit të këtyre ekipeve, Kompania e Deminimit nuk ka pësuar asnjë aksident apo lëndim, shprehet kolonel Haziri. Vlen të theksohet se që nga paslufta në Kosovë, janë pastruar mbi 50 milionë metra katrorë dhe janë gjetur dhe shkatërruar mbi 90 000 mjete të pashpërthyera eksplozive. Pas luftës në Kosovë kanë qenë evidentuar rreth 4500 zona të rrezikshme, ndërsa tani kanë mbetur të pa pastruara rreth 100 zona të rrezikshme. Sipas Strategjisë së miratuar nga Ministria e Mbrojtjes pritet që të gjitha këto zona të pastrohen deri në vitin 2024.

Policët e FSK-së trajnohen për „Mbrojtje të afërt“

Prishtinë, 29 korrik 2019 - Në kuadër të përgatitjeve dhe mbajtjes së gjendjes së gatishmërisë, pjesëtarët e Policisë të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) janë duke ndjekur trajnimin për „Mbrojtje të afërt“ nga instruktori i licencuar ndërkombëtar Ismet Mehmeti. Në këtë trajnim, i cili ka filluar më 22.07 dhe do të përfundojë më 02.08.2019, janë duke marrë pjesë 15 pjesëtarë të cilët po pajisen me njohuri rreth punës së tyre të përditshme për sa i përket teknikave të avancuara në mbrojtjen e afërt. Për të parë nga afër trajnimin e pjesëtarëve të Policisë së FSK-së, sot ishin për vizitë edhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe stafi i tij udhëheqës. Me këtë rast, pjesëtarët e FSK-së së bashku me instruktorin demonstruan disa nga taktikat që i kanë mësuar gjatë këtyre ditëve. Gjeneral Cikaqi, pasi i përgëzoi pjesëmarrësit për vullnetin dhe disiplinën



e treguar gjatë këtij trajnim shtoi: “Vazhdoni me këtë ritëm dhe shfrytëzoni këto ditë në mënyrën më të mirë të mundshme që të përfitoni sa më shumë nga instruktori, i cili është duke qëndruar këto ditë pranë jush” Trajnimi “Mbrojtja e afërt” përmban pjesën teorike dhe praktike të teknikave dhe metodave të arrestimit, prangosjes, përdorimit të shufrave, mbrojtjes së VIP-ve etj.

Pjesëtarë të FSK-së certifikohen në trajnimin “Mbijetesa në zona pyjore”

Pomozotin, 26 korrik 2019 - Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, në Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, u mbajt ceremonia e certifikimit të 14 pjesëtareve të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK-së), të cilët përfunduan me sukses trajnimin “Mbijetesa në zona pyjore”.



Pjesëmarrësit u sprovuan në temat si: prioritetet në situata të mbijetesës; orientimi në hapësire pa përdorur busull dhe psikologjia e mbijetesës. Përmbajtja e trajnimit rreth mbijetesës në vende malore ndërlidhej me strehën, zjarrin, ujin dhe ushqimin. Trajnimi „Mbijetesa në zona pyjore”, që është mbajtur nga instruktorët e Qëndresë së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, përfshinte pjesën teorike dhe atë praktike.

Gjatë fazës praktike, pjesëtarët nuk kanë pasur mundësi të përdorin gjësende të rehatshme si tenda apo çanta për fjetje, por është dashur që vet të sigurojnë edhe ushqimin dhe ujin. Gjithashtu, ata kanë marshuar shumë kilometra, kanë naviguar dhe janë ballafaquar me shumë detyra të tjera sfiduese. Gjatë ceremonisë së certifikimit, në fjalën e tij drejtori i Qendrës së Trajnimit për Kërkim Shpëtim John Doone theksoi se “këto teknika të vështira mund të mësohen vetëm nga tereni, duke ushtruar në të gjitha rrethanat, natën dhe ditën, në erë dhe në shi, në të ftohtë dhe në vapë të madhe për të parë çfarë mund të funksionoj e çfarë jo”. Ai gjithashtu shtoi se “shumë njerëz besojnë se është i mjaftueshëm leximi i librave apo shikimi i videove për t’i realizuar këto teknika. Asgjë nuk është kaq reale dhe kaq sfiduese sesa puna praktika, andaj kjo është edhe ajo çfarë ne ofrojmë”. Të pranishëm në ceremoninë e certifikimit ishin edhe komandanti i Kompanisë së Kërkim-Shpëtimit, nënkolonel Heset Malsiu dhe shefi i Komunikimit, major Fadil Sahiti.

23 pjesëtarë të Batalionit të Parë të FSK-së përfunduan trajnimin „Komando dhe Bjeshkatari“



Gjilan, 04 korrik 2019 - Sot në Batalionin e Parë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Gjilan u mbajt ceremonia e certifikimit të trajnimit „Komando dhe Bjeshkatari“. Ky lloj trajnim është i rëndësisë së veçantë sepse përgatitë ushtarakë dhe liderë me standarde të larta profesionale, për të operuar në një mjedis operacional dhe kompleks, duke performuar aftësi dhe shkathtësi të avancuara teknike dhe taktike në përmbushje të misionit. Në këtë trajnim që ka zgjatur 10 javë janë zhvilluar këto tema: navigimi tokësor (ditën dhe natën), formacionet e lëvizjes nëpër zona të rrezikshme dhe të minuara, ballafaqimi me mjete shpërthyese, kundërpërgjigje ndaj pritës, ngjitje dhe zbritje nëpër male të pjerrëta dhe shkëmbinj, kalim të lumenjve etj.

Në trajnimin “Komando dhe Bjeshkatari“, i cili është mbajtur në kohë, vende dhe kushte të ndryshme atmosferike, janë sfiduar pjesëtarët duke operuar në terrene të vështira dhe të panjohura gjatë periudhës dhjetë javore. Vlen të ceket se 23 pjesëtarët kanë arritur ta menaxhojnë mirë këtë situatë. Ky trajnim është realizuar nga instruktorët e Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë.

Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm komandant i KFT-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, zv. komandant i BRSH-së, kolonel Hysen Dreshaj, komandanti i kontingjentit turk, koloneli Numan Bash etj. Gjenerali Enver Cikaqi falënderoi shtetin turk për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme në zhvillimin e FSK-së, si dhe instruktorë për mbështetjen e përhershme të pjesëtarëve të FSK-së.

Sport

Kapiteni Blerand Hasanaj shpallet katër herë kampion i Kosovës në automobilizëm



Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, kapiteni Blerand Hasanaj, është edhe një sportist i dalluar dhe mjaft i suksesshëm në fushën e automobilizmit. Ai me automobilin e tij, ka zënë katër herë vendin e parë dhe njëherësh shpallet kampion i Kosovës, për vitet: 2012,2014,2017 dhe 2018.

Edhe në vitin 2019, Blerandi ka filluar garat me sukses, ku momentalisht renditet në vendin e dytë, ku kanë mbetur edhe tri gara deri në përfundim. Synimi i tij është që edhe kësaj radhe të shpallet kampion. Nëse Hasanaj arrin edhe këtë vit të fitojë kampionatin, nga Federata e Automobilizmit të Republikës së Kosovës, do të marrë titullin ''Helmeta e Artë", titull ky i cili fitohet vetëm nëse garuesi i bën 5 tituj, apo nëse i arrin 3 tituj të njëpasnjëshëm; kusht ky, që Hasanaj do ta përmbushë në të dy rastet. Oficeri i Forcës së Sigurisë z. Hasanaj me këtë sport ka filluar të merret qysh në moshën 12 vjeçare në Go-Kart. Me veturën e tij të parë për gara të tipit „Opell Kadet” prodhim i vitit 2010, arriti të bëhet kampion 4 herë (2012, 2014, 2017, 2018).



Klubi i motoristëve nga diaspora vizituan FSK-në

Prishtinë, 26 korrik 2019 - Në kazermën e Forcës së Sigurisë të Kosovës „Adem Jashari“ në Prishtinë, qëndruan sot për vizitë 40 mërgimtarë shqiptarë nga Zvicra, të bashkuar në klubin e motoristëve “Shqiponja”. Gjatë kësaj vizite, motoristët u mirëpriten nga komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Hasan Hoxha, si dhe nga oficerë të lartë të FSK-së.

Me këtë rast, gjeneral Cikaqi pasi i përshëndeti sportistët dhe i falënderoi për vizitën, në pika të shkurtra i njoftoi me zhvillimet dhe të arriturat e FSK-së në përgjithësi. I kënaqur që ndodhet në Ushtrinë e Kosovës, shprehet edhe kryetari i këtij klubi, z. Safet Baftijaj, duke thënë se ndjehet mjaft i kënaqur që ndodhet në mesin e ushtarëve të Kosovës, “të cilët çdo ditë e më tepër në diasporën na bëjnë të ndihemi krenarë”. Më pas, përmes një takimi të shkurtër, shefi i Departamentit të Planifikimeve në KFT, kolonel Sefer Shyti, i informoi mysafirët nga diaspora lidhur me misionin, strukturën, detyrat e FSK-së, numrin, trajnimet si dhe për sukseset e përgjithshme të FSK-së.



FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 83 • 13 Gusht 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Emërime dhe gradime në Ushtrinë e Kosovës

Presidenti Hashim Thaçi dekretoi emërimin dhe gradimin e gjeneralëve të Ushtrisë së Kosovës



Prishtinë, 13 gusht 2019 - Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, në mbështetje të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më datë 1gusht 2019, ka bërë emërimin dhe gradimin e gjeneralëve të FSK-së, si më poshtë: Gjeneral brigade Enver Cikaqi, gradohet në gradën Gjeneralmajor i FSK-së dhe emërohet Zëvendëskomandant i FSK-së; Gjeneralmajor Bashkim Jashari emërohet Inspektor gjeneral në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes; Gjeneralmajor Gëzim Hazrolli emërohet Drejtor i Drejtorisë së Inteligjencës në Ministrinë e Mbrojtjes; Gjeneral brigade Nazmi Brahimaj emërohet Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes; Gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj emërohet Komandant i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së; Gjeneral brigade Xhevahir Geci emërohet Komandant i Komandës së Gardës Kombëtare të FSK-së; Gjeneral brigade Naim Haziri emërohet Komandant i Komandës së Logjistikës së FSK-së; Gjeneral brigade Irfete Spahiu emërohet Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së; dhe Kolonel Jeton Dreshaj gradohet në gradën Gjeneral brigade i FSK-së dhe emërohet Shef në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së. Dekretimi dhe emërimi i gjeneralëve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Kosovës – FSK, ka hyrë në fuqi dje, më 12 gusht 2019.

Në Ministri të Mbrojtjes

Ministri dhe komandanti pritën në vizitë shefin e Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s



Prishtinë, 8 gusht 2019 - Ministri i Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pritën sot, në takime të ndara, në Ministrinë e Mbrojtjes, z. Michel Soula, shef i Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s, të shoqëruar nga drejtori i Ekipit këshillues dhe ndërlidhës të NATO-s(NALT), gjeneral brigade Michael Oberneyer dhe këshilltar nga ekipi i NALT-it. Së pari, Ministri Berisha e falënderoi shefin e Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s për angazhimin e NATO-s për paqe dhe siguri në Kosovë, për bashkëpunimin e shkëlqyer me KFOR-in dhe Ekipin e NALT-it, si dhe për angazhimin dhe interesimin e NATO-s për Kosovën, sigurinë dhe prosperitetin e saj.Më tej, ministri i Mbrojtjes e njoftoi përfaqësuesin e NATO-s lidhur me procesin e tranzicionit, kryesisht angazhimin me prioritet për zbatimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së, duke rikonfirmuar se ky proces do të jetë transparent dhe i bashkërenduar, që garanton zhvillimin e një Force të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës, si një Forcë që do të kontribuojë për paqe dhe siguri në rajon dhe më gjerë.

Ministri gjithashtu theksoi se deklaratat e pamatura të zyrtarëve të lartë të Serbisë nuk i kontribuojnë ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në rajon dhe mund ta nxisin rritjen e tensioneve ndëretnike. Ai shtoi se Kosova është e përkushtuar ndaj vlerave euroatlantike dhe se FSK-ja është e gatshme që edhe me kapacitetet e tanishme t'i përkrahë aleatet kurdo që kërkohet prej saj.Z. Soula e përgëzoi ministrin Berisha për transparencën ndaj partnerëve, punën profesionale dhe bashkëpunimin e mirë me NALT-in dhe KFOR-in. Ai theksoi se NATO-ja ka një përkushtim afatgjatë ndaj Kosovës dhe se përkrahja përmes NALT-it për FSK-në do të vazhdojë edhe më tej. Z. Soula e njoftoi ministrin edhe për diskutimet e nivelit të lartë në NATO rreth bashkëpunimit NATO-FSK, në të ardhmen.Ministri Berisha shprehu bindjen se diskutimet brenda NATO-s rreth marrëdhënieve me FSK-në do të avancojnë dhe se aleatët do të marrin vendime që u shërbejnë thellimit të raporteve tona, besimit të ndërsjellë dhe stabilitetit në rajon. Gjithashtu, edhe në takimin e gjeneral Ramës me zyrtarin e lartë të NATO-s, z. Soula u bisedua për bashkëpunimin e mirë ndërmjet NATO-s dhe FSK-së, nëpërmjet NALT-it dhe këshilltarëve të NATO-s, si dhe për përkushtimin e vazhdueshëm që ka Kosova për të qenë shtet anëtar i NATO-s si dhe shtet i integruar në Bashkimin Evropian.

Suksese të reja të kadetëve të FSK-së në SHBA

Kadetja Arelena Shala emërohet në zingjirin komandues të kadetëve në Akademinë Ushtarake Amerikane West Point



Arelena Shala, kadete e Forcës së Sigurisë të Kosovës, në bazë të rezultateve të shkëlqyera gjatë studimeve në Akademinë Ushtarake Amerikane „West Point" në Nju Jork, është emëruar rreshtermajor i Komandës së Regjimentit në zingjirin komandues të kadetëve të Akademisë Ushtarake, si e vetmja kadete ndërkombëtare, në mesin e 4400 kadetëve sa ka Akademia më elitare amerikane.

Kadetët nga Kosova, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku, janë dy kadetë të cilët kanë fillu-ar studimet në këtë akademi në vitin shkollor 2016/2017. Certifikatën e pranimit në këtë akademi, asokohe ua pat dhënë solemnisht ambasadori amerikan në Kosovë.

Akademia Ushtarake e SHBA-ve në West Point është një kolegj katërvjeçar, bashkë-edukues, federativ, liberal i arteve, i vendosur 50 milje në veri të Nju Jorkut. Kjo akademi u themelua që në vitin 1802, si kolegji i parë i inxhinierisë në Amerikë, i cili edhe sot vazhdon të jetë institucioni kryesor i zhvillimit udhëheqës në botë, i radhitur vazhdimisht në mesin e kolegjeve më të mira në vend.

Mision i Akademisë Ushtarake Amerikane „West Point" vazhdon të mbetet edukimi, stërvitja dhe frymëzimi i korpusit të kadetëve, në mënyrë që çdo i diplomuar të jetë një drejtues i përkushtuar ndaj Detyrës, Nderit dhe Vendit, si dhe i përgatitur për një karrierë të përsosmërisë profesionale dhe shërbimit ndaj kombit.

Ministri Rrustem Berisha priti në takim lamtumirës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar Ruairi O'Connell



Prishtinë, 16 gusht 2019 - Ministri i Mbrojtjes z. Rrustem Berisha, priti dje në takim lamtumirës Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Ruairi O'Connell. Në takim Ministri e falënderoi Ambasadorin për kontributin e tij të veçantë në thellimin e mëtejmë të raporteve dypalëshe midis Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Ai e cilësoi Ambasadorin O'Connell si mik të madh të Republikës së Kosovës, i cili do të na mungojë të gjithëve.

Në takim u bisedua edhe për progresin e arritur në zbatimin e Planit Gjithëpërfshirës së Tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe përkrahjen e pa rezervë që ka dhënë dhe po jep Mbretëria e Bashkuar në shkollimin dhe stërvitjen e pjesëtarëve të FSK-së. Me theks të veçantë u diskutua suksesi i kadetëve tanë gjatë shkollimit në Mbretërinë e Bashkuar dhe vende tjera. Ata i kanë përfaqësuar më së miri vlerat që kultivon FSK-ja si një Forcë profesionale, multietnike dhe kredibile.

Ambasadori O'Connell e falënderoi Ministrin për bashkëpunimin e deritashëm dhe nënvizoi se FSK-ja është një prej sukseseve të Kosovës pas luftës. Ai shtoi se FSK-ja është ndërtuar si institucion duke u bazuar në meritë dhe profesionalizëm. Ambasadori gjithashtu e rikonfirmoi përkushtimin e Mbretërisë së Bashkuar për ta vazhduar përkrahjen ndaj Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ministri Berisha edhe një herë shprehu gatishmërinë që FSK-ja, edhe me kapacitetet e tanishme, të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, gjithashtu edhe si pjesë e kontingjenteve të partneriteteve strategjikë, siç është Mbretëria e Bashkuar, në misionet paqeruajtëse në botë.

Në Ministri të Mbrojtjes

Numër i lartë i ushtarakëve dhe civilëve i përgjigjen aksionit humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut



Prishtinë, 5 gusht 2019 - Ushtarakë dhe civilë të Ministrisë së Mbrojtjes i përgjigjen aksionit humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut Sot, në Ministrinë e Mbrojtjes filloj aksioni humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut, sesioni i dytë për këtë vit, për nevoja të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës dhe nëpërmjet saj për pacientët në nevojë. Ushtarakë dhe civilë, gra e burra, punonjës të Ministrisë së Mbrojtjes pa dallim në detyra dhe grada, u përgjigjen masivisht aksionit humanitar për dhurimin e gjakut, disa edhe për të dytën herë brenda këtij viti, e shumica prej tyre janë tanimë janë dhurues të rregullt.



Dhurues i rregullt vullnetar është edhe gjeneral major Gëzim Hazrolli, drejtor i drejtorisë së Operacioneve i cili së bashku me stafin tjetër të Ministrisë së Mbrojtjes i përgjigjen çdoherë këtij aksioni shumë human. Mbarëvajtjen e aksionit nga afër e përcollën, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, drejtor i departamentit për Çështje Mjekësore në Ministrinë e Mbrojtjes si dhe drejtoresha e Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut, dr. Bukurije Zhubi. Nga mëngjesi dhe derë më tani, aksionit i janë përgjigjur mbi 50 dhurues vullnetar të gjakut dhe pritet që deri në mbarim të orarit të punës ky numër të jetë akoma më i madh.

Aksioni humanitar i dhurimit vullnetar të gjakut, i dyti për këtë vit, po zhvillohet bazuar në planin e veprimit për vitin 2019 të drejtorisë për Politika dhe Plane, përkatësisht departamentit për Bashkëpunim Civil-Ushtarak dhe drejtorisë së Operacione/ departamenti për Çështje Mjekësore dhe do të vazhdojë të zhvillohet në të gjitha kazermat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deri më datë 2 shtator 2019.

Gjeneral Enver Cikaqi priti në takim lamtumirës nënkolonelët Rehenberg dhe Wienecke



Prishtinë, 23 gusht 2019 Zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjeneral major Enver Cikaqi, priti sot në takim lamtumirës Këshilltarin për Operacione të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), nënkolonel Hans Rehenberg dhe këshilltarin për Operacione, Ushtrime dhe Trajnime nga NALT-i, nënkolonel Manfred Wienecke, të cilët po e përfundojnë misionin e tyre në Kosovë.

Me këtë rast, gjeneral Cikaqi i falënderoi të dy nënkolonelët për bashkëpunimin e deritanishëm dhe angazhimin e tyre në vazhdimësi për avancimin e FSK-së, duke i nderuar edhe me nga një Mirënjohje.

Ndërkaq, nënkoloneli Rehenberg dhe nënkoloneli Wienecke, e falënderuan gjeneral Cikaqin dhe të gjithë bashkëpunëtorët, me të cilët ata bashkëpunuan gjatë shërbimit të tyre, duke u shprehur të lumtur që patën rastin të punojnë me ta në FSK.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Pas përfundimit të misionit në Kosovë

Ministri Berisha dhe Komandanti Rama i dhurojnë „Medalje për shërbim të shquar“ nënkolonelit Henrik Krogh

Oficeri Danez, nënkoloneli Henrik Krogh gjatë viteve të shërbimit në kuadër të NALT-it ka dhënë kontribut të çmuar në procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai, po ashtu ka qenë i angazhuar në Kosovë qysh në vitin 1999 si anëtar i grupit të forcave daneze në kuadër të KFOR-it, ndërsa, në vitin 2004 ka qenë komandant i kontingjentit danez dhe në vitin 2008 ka shërbyer si zyrtar ndërlidhës i KFOR-it në Qeverinë e Kosovës.



Prishtinë, 8 gusht 2019 - Sot, në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ceremonia përcjellëse për nënkolonel Henrik Krogh, ushtrues detyre i shefit të këshilltarëve të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), me rastin e përfundimit të misionit të tij në Kosovë, në kuadër të NALT-it. Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, në emër të Ministrisë e falënderoi nënkolonelin danez Krogh për kryerjen e detyrave me përkushtim në kuadër të NALT-it si dhe për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e shkëlqyer në të gjitha çështjet me interes për zhvillimin dhe profesionalizmin e FSK-së.

Ministri i Mbrojtjes, për meritа të veçanta gjatë shërbimit të tij, nënkolonelit Krogh i dhuroi „Medaljen për shërbim të shquar“.

Nga ana e tij, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandant i Forcës së Sigurisë të Kosovës, nënkolonelin Henrik Krogh e dekoroi me „Medaljen për Shërbim“, në shenjë falënderimi për kontributin e tij dhënë Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Oficeri i lartë nga Danimarka, nënkolonel Krogh gjatë takimit evokoi kujtime mbresëlënëse nga misioni i tij në Kosovë, në veçanti shprehu falënderim për mikpritjen e institucioneve dhe të popullit të Kosovës, duke nënvizuar se Kosova gjithmonë do të mbetet në zemrën e tij.

Oficeri danez Krogh gjatë takimit evokoi kujtime mbresëlënëse nga misioni i tij në Kosovë, në veçanti shprehu falënderim për mikpritjen e institucioneve dhe të popullit të Kosovës, duke nënvizuar se Kosova gjithmonë do të mbetet në zemrën e tij.

Nënkoloneli Krogh gjatë viteve të shërbimit në kuadër të NALT-it ka dhënë kontribut të çmuar në procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai, po ashtu ka qenë i angazhuar në Kosovë qysh në vitin 1999 si anëtar i grupit të forcave daneze në kuadër të KFOR-it, ndërsa, në vitin 2004 ka qenë komandant i kontingjentit danez dhe në vitin 2008 ka shërbyer si zyrtar ndërlidhës i KFOR-it në Qeverinë e Kosovës.





Gjenerali Xhevahir Geci falënderoi nënkolonelin Krogh për kontributin e dhënë në profesionalizimin e FSK-së



Prishtinë, 6 gusht 2019 - Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Xhevahir Geci, priti sot në takim lamtumirës ushtruesin e detyrës së shefit të këshilltarëve të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), nënkolonel Hnrik Krogh.Me këtë rast, gjeneral Geci e falënderoi nënkolonelin Krogh për bashkëpunimin e deritanishëm, angazhimin dhe mbështetjen e tij të pakursyer, si dhe kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë për FSK-në gjatë periudhës së shërbimit të tij në Kosovë. Gjeneral Geci gjithashtu e falënderoi Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK(NALT), për ndihmën e vazhdueshme të këtij ekipi për FSK-në.I kënaqur nga bashkëpunimi që kishte me FSK-në u nda edhe nënkoloneli Krogh, i cili e vlerësoi lart bashkëpunimin e NALT-it me FSK-në dhe mikpritjen e institucioneve dhe popullit të Kosovës në përgjithësi.

Demineret e FSK-së, demoluan mbi 200 mjete eksplozive të pashpërthyera

Prishtinë, 26 gusht 2019 - Në kuadër të operacioneve të pastrimit të fushëbetejave; pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit (EOD) të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjatë javës së kaluar kanë gjetur mbi 200 mjete eksplozive të pashpërthyera në Parkun e Lirisë në Ferizaj. Pas sigurimit të zonës është bërë transportimi i këtyre mjeteve në poligonin e Harilaqit, të cilat janë demoluar nga pjesëtarët e EDO-së të FSK-së dhe ata të EOD-së të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Për vite me radhë, Kompania e Deminimit ka qenë e angazhuar në pastrimin e fushave të kontaminuar me mjete të pashpërthyera, ku janë kryer operacione deminimi në pastrimin e shumë fushëbetejave. Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Kompania e Deiminimit, vazhdon të mbetet e përkushtuar në ofrimin e sigurisë së qytetarëve ndaj mjeteve të pashpërthyera, dhe i lut qytetarët e Republikës së Kosovës që nëse hasin në ndonjë mjetë të dyshimtë të raportojnë tek organet e sigurisë.



Pas trajnimit Bazik nëntë-javorë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj

Betohen solemnisht për shërbim ndaj Atdheut 347 rekrutë të rinj të FSK-së

Rekrutët të cilët sot u certifikuan dhe bënë betimin për shërbim janë gjenerata e parë për vitin 2019 të FSK-së, me mandat të ri. Prej numrit të përgjithshëm të rekrutëve 52 prej tyre janë të gjinisë femërore dhe 22 pjesëtarë vijnë nga radhët e komuniteteve jo shumicë.





Prishtinë, 9 gusht 2019 - Në kazermën „Adem Jashari'' të Forcë së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë, në prani të ministrit të Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha dhe komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhanë betimin solemn për shërbim në FSK 347 rekrutë të rinj, pas përfundimit të Trajnimit Bazik nëntë-javorë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Në ceremoninë e betimit të rekrutëve të rinj, gjenerata e parë e FSK-së me mandat të ri, ishin të pranishëm edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, zëvendësministri Kadri Kastrati, drejtori i ekipit këshillues dhe ndërlidhës të NATOS- për FSK-në (NALT), si dhe gjeneralë të FSK-së, KFOR-it, atashe ushtarakë të akreditуar në Kosovë dhe familjarë të rekrutëve të rinj.

Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha foli për rëndësinë e betimit të ushtarit për shërbim ndaj vendit: „Kjo është një datë me rëndësi për karrierën dhe jetën tuaj, për FSK-në, Ministrinë e Mbrojtjes dhe shtetin e Kosovës. Nuk ka detyrë më të ndershme se sa t'i shërbesh vendit dhe të kontribuosh në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend dhe më gjerë. Ju jeni gjenerata e parë e ushtarëve që keni nderin t'i bashkoheni FSK-së me mandat të ri ushtarak. Si Ministër i Mbrojtjes, jam krenar me vajzat dhe djemtë tanë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, të cilët me sukseset e tyre në shkollat dhe trajnimet e përfunduara në akademitë e ndryshme të vendeve të NATO-s, kanë treguar performancë të shkëlqyer dhe kanë përfaqësuar me nder FSK-në. Pres që edhe ju ta ndiqni shembullin e tyre"-shprehet ministri Berisha.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli në këtë ceremoni duke i uruar rekrutët e rinj të FSK-së dhe FSK-në në përgjithësi për sukseset e arritura, falënderoj edhe partnerët strategjik të Kosovës dhe NATO-n për mbështetjen e FSK-së. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama para ushtarëve të rreshtuar, u shpreh: „Kam kënaqësinë dhe nderin që si Komandant i FSK-së të ju drejtohem juve ushtarë të nderuar, për përfundimin me sukses të Trajnimit Bazik.



Ky trajnim, i cili ka zgjatur 9 javë, ka vendosur themelet bazë për karrierën tuaj ushtarake. Ky profesion fisnik kërkon angazhim dhe përkushtim maksimal për t'i shërbyer vendit me nderë dhe dinjitet. Prandaj, unë sot jam shumë i lumtur që ju jeni ata të cilët me angazhimin tuaj keni dëshmuar se Forca e Sigurisë së Kosovës, nga sot, në radhët e veta do ti ketë djemtë dhe vajzat më të zotë e këtij vendi".

Komandanti i FSK-së në fund pati edhe një këshillë për ushtarët e rinj; „Gjatë karrierës tuaj, ju do të ballafaqoheni me sfida të ndryshme, andaj nga ju pritet që të jeni të disiplinuar, të përkushtuar, dhe gjithmonë të përgatitur t'i kryeni detyrat sipas udhëzimeve të eprorëve tuaj". Lëvdatë për sukseset e larta të arritur gjatë stërvitjes u shpërblyen rekrutët: Shpëtim Halilaj, Luan Gashi, Diar Statovci, Donika Rexhepi, Blerta Veliu, Edmond Thaçi, Altin Krasniqi, Ermeka Muja, si dhe për shkathtësi të lartë fizike u shpërblyen Gentrit Gashi dhe Doruntinë Cana. Rekrutët të cilët sot u certifikuan dhe bënë betimin për shërbim janë gjenerata e parë për vitin 2019. Gjithsejtë 337 rekrutë, prej tyre 52 të gjinisë femërore dhe 22 pjesëtarë nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Intervistë me pilotin e ri të FSK-së, nëntogerin Atdhe Hasani

Ndihem shumë i lumtur dhe krenar që i shërbejë Ushtrisë së Kosovës

Gjatë muajit maj, të këtij viti, diplomuan dy pilotë të Ushtrisë së Kosovës, nëntogerët Atdhe Hasani dhe Krenar Voca, të cilët përfunduan me rezultate të shkëlqyera shkollimin për pilot helikopteri në Akademinë Ushtarake në Republikën e Turqisë. Kjo, edhe ishte arsyeja që për gazetën e FSK-së, ‚Forca Jonë, të zhvillojmë intervistë, me nëntogerin Atdhe Hasanin.

Gazeta „Forca Jonë“: Çka do të thotë për Ju, të jeni pilot i Ushtrisë së Kosovës/FSK-së?

Nëntogeri Atdhe Hasani: Unë si pilot i dytë ushtarak i Kosovës ndihem shumë i privilegjuar që më është besuar kjo detyrë nga eprorët e mi. Të jesh pilot nuk është diçka e vogël, veçanërisht në Kosovë, duke pasur parasysh se jam ndër të parët në këtë drejtim, ndihem shumë i lumtur dhe krenar që mbajë këtë uniformë. Për aq sa është privilegj është edhe përgjegjësi, sepse Kompania e Aviacionit është një njësi e cila nuk ka qenë aktive në të kaluarën, andaj ne jemi dy pilotët e parë që jemi ngarkuar me një barrë të rëndë mbi supe, që të ndërtojmë çdo gjë nga fillimi. Qëllimi ynë është që në një kohë sa më të shkurtër të arrijmë të kompletohemi me personel, dhe në një të ardhme të afërt, Njësia e Aviacionit të pajiset me helikopterë dhe pajisje të tjera, në mënyrë që sa më shpejt të mund t'i arrijë kapacitetet e plota operacionale.



Gazeta „Forca Jonë“: Cili ishte itinerari i studimeve, sukseset dhe vështirësitë që keni hasur gjatë studimeve ?

Nëntogeri Atdhe Hasani: Në fillim duhet cekur se, për t'u bërë pilot, çdo kandidat për pilot duhet të jetë oficer me akademi ushtarake të përfunduar, dhe unë si pilot ushtarak për helikopter e kam përfunduar akademinë ushtarake të forcave tokësore në Turqi, që ka zgjatur 5 vjet. Të gjithë i dimë vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet çdo kadet gjatë studimeve në akademinë ushtarake. Për mua që e kam përfunduar akademinë ushtarake në Turqi vështirësitë kanë qenë edhe më të mëdha, duke filluar që nga tradita, ushqimi, komunikimi i rrallë me familjen, mosnjohja e gjuhës turke, sidomos në vitin e parë të akademisë. Mirëpo me mbështetjen e familjes si dhe mbështetjen që i kemi ofruar njeri-tjetrit si shoqëri gjatë gjithë kohës, arrita që t'i tejkalojë këto vështirësi, duke i kthyer të gjitha në sukses. Ne kadetët shqiptarë e treguam aq shumë veten sa që ishim të ngarkuar edhe me detyra dhe pozita që rrallëherë ngarkoheshin studentët e huaj. Njëra nga këto arritje ishte edhe detyra që mu besua si kadet i vitit të katër, ku për 6 muaj isha në pozitën e zëvendëskomandantit të Batalionit dhe shef i S2-it dhe S4-it.



Edhe gjatë shkollimit për pilot të helikopterit, hasa në vështirësi. Përveç vështirësive që sillte mësimi i mjeshtërisë dhe teknikave të drejtimit të helikopterit, i cili kërkonte përkushtim maksimal si në teori ashtu edhe në praktikë, ishte edhe ndjenja e përgjegjësisë se a do të mund të kthehem me kokën lart dhe të shërbej në fushën e aviacionit në vendin tim. Vlen të cekët se me sukseset e treguara në Shkollën e Aviacionit Tokësorë në Turqi, dëshmuam se Kosova ka djem dhe vajza të përgatitur. Unë u radhita si piloti i dyti i gjeneratës sime (gjenerata 58), dhe i vetmi në gjeneratë arrita që ta fitoj kushtin që në vitet në vijim të mund t'i ndjek studimet për instruktor piloti.

Gazeta „Forca Jonë“: Në këtë qendër ushtarake - (vendi-shkolla, a ka pasur studentë të shteteve tjera dhe cili ishte dallimi profesional) në cilat fusha të tjera jeni përgatitur?

Nëntogeri Atdhe Hasani: Po, gjatë studimeve në Akademinë Ushtarake ka pasur edhe studentë nga shtetet tjera. Kemi qenë diku rreth 25 shtete të huaja. Ne shqiptarët kemi qenë me fat që një pjesë e madhe e kadetëve para se të fillojmë akademinë ushtarake kemi qenë pjesë e FSK-së, gjë që na ka ndihmuar të jem më të përgatitur sesa studentët e vendeve të tjera, si në disiplinë, në qëndrim ushtarak, në njohjen dhe përdorimin i armëve, në qitje me armë, në fitnes fizik, etj. Sa i përket shkollimit për pilot helikopteri Turqia deri me tani ka marrëveshje vetëm me Kosovën. Mund të themi lirisht se gjatë përgatitjeve profesionale të gjithë jemi trajtuar krejtësisht njëjtë me pilotët turq.

Gazeta „Forca Jonë“: Si janë trajtuar kadetë e huaj në akademi ?

Nëntogeri Atdhe Hasani: E ceka edhe më herët se në Akademi kemi qenë diku rreth 25 kadetë të shteteve të huaja. Sa i përket pjesës akademike dhe ushtarake asnjëherë nuk është bërë ndonjë dallim as për ne si shqiptarë e as për kadetët tjerë të vendet e ndryshme të botës. Çdo herë jemi trajtuar njëjtë me kadetët turq. Sigurisht se ne të gjithë kadetët e huaj në fillim kemi hasur në vështirësi sa i përket pjesës akademike, sepse niveli ynë i gjuhës turke nuk ishte i mjaftueshëm që t'i kuptojmë të gjitha gjërat me kohë.

Gazeta „Forca Jonë“: Cila është përvoja praktike në lëmin e pilotimit ?

Nëntogeri Atdhe Hasani: Sa i përket praktikës në lëmin e pilotimit, sipas marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Turqisë, kemi qenë të planifikuar për trajnimin bazik për pilot të helikopterit, i cili zgjatë 48 javë dhe është i ndarë në 6 fusha, gjithsej 140 orë fluturim (fluturimet bazike 30 orë me AB-206, fluturime bazike 30 orë me UH-1, fluturimet në rast emergjence 20 orë me UH-1, fluturimet përmes radio-sinjaleve 30 orë, në simulator, fluturimi taktik 15 orë me UH-1 dhe fluturimi natën 15 orë me UH-1). Mirëpo për arsye se gjatë kohës së trajnimit sa isha në Turqi ndodhen dy aksidente me fatalitet me tipin e helikopterit UH-1, i cili ka qenë i planifikuar për fluturime për ne kandidatët për pilotë morën vendim për largimin e këtij helikopteri nga përdorimi dhe pastaj gjenerata e 58, në të cilën isha edhe unë, kemi vazhduar vetëm me helikopterin e tipit AB-206, gjithsej 60 orë fluturim. Pas përfundimit të shkollimit bazik për pilot të helikopterit nuk e kam pasur mundësinë që të fluturojë përsëri deri me tani, mirëpo jemi në pritje të realizimit të një marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, ku shumë shpejt do ta filloj praktikën bashkë me pilotët shqiptarë.



Gazeta „Forca Jonë“: Si përjetohet fluturimi në qiell të hapur?

Nëntogeri Atdhe Hasani: Për mua është një adrenalinë e përcjellë me shumë përgjegjësi, të cilën nuk mund ta përshkruaj. Shpesh herë nga përgjegjësia e madhe që kemi nuk mund ta shijojmë kënaqësinë e pilotimit në maksimum. E veçanta e pilotimit me helikopter është se fluturimet nuk bëhen në lartësi të mëdha, gjë që na mundëson t'i shijojmë bukuritë e mrekullueshme të natyrës nga një anë që jo të gjithë e kanë këtë mundësi.

Gazeta „Forca Jonë“: Cili është mesazhi juaj drejtuar të rinjve që dëshirojnë të bëhen pilotë?

Nëntogeri Atdhe Hasani: Mesazhi im për të rinjtë e Kosovës është që së pari t'i vendosin mirë synimet dhe që nga ai moment të fillojnë të punojnë për realizimin e tyre, qoftë për pilot apo për çfarëdo fushë tjetër. Vetëm me shumë punë dhe të bashkuar mund të arrijmë që edhe ne të jemi krah për krah me shtetet e tjera të botës.

Drejtori i NALT-it vazhdon vizitat informuese në FSK

Gjenerali Michael Oberneyer njoftohet me zhvillimet e BRSH-së nga gjenerali Fadil Hadërgjonaj



Istog, 15 gusht 2019 - Në kazermën „Ushtarët e NATO-s“ në Istog, ka qëndruar dje për vizitë pune drejtori i NALT-it (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s në FSK), gjeneral brigade Michael Oberneyer, i cili u prit nga komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj. Gjatë takimit, komandanti i BRSH-së e njoftoi gjeneralin Oberneyer për tranzicionin e FSK-së, aktiviteteve aktuale të BRSH-së, vizionin e tij për të ardhmen e brigadës, si dhe për mundësitë e bashkëpunimit dhe avancimit të kësaj brigade.

Gjenerali Hadërgjonaj e njoftoi drejtorin e NALT-it edhe për ushtarët e rinj, të cilët gjatë kësaj jave u bënë pjesë e BRSH-së, pranimi i të cilëve do të rezultojë në forcimin dhe avancimin e menjëhershëm të brigadës. Pas takimit ata vizituan edhe Batalionin e Dytë të BRSH-së, ku përmes një brifingu informues e njoftuan drejtorin e NALT-it dhe ekipin e tij për aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë e Batalionit të Dytë. Krahas kësaj, vizituan edhe Qendrën mjekësore, ku nga ekipi i mjekëve u njohën nga afër me pajisjet që posedon kjo qendër, si dhe u informuan për procedurat e aplikimit mjekësor, kontrollet mjekësore periodike dhe ato nëpër fshatra, të banuara kryesisht me minoritete, në zonën e përgjegjësisë së Batalionit të Dytë të BRSH-së.

Nga ana e tij, gjenerali Oberneyer së pari e uroi gjeneral Hadërgjonajt për emërimin dhe dekretimin e tij si komandant i Forcave Tokësore nga Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, dhe më pas e falënderoi për mikpritjen dhe e përgëzoi për arritjet profesionale të BRSH-së, duke premtuar mbështetje për arritjen e objektivave në të ardhmen.

Gjeneral Naim Haziri e njoftoi gjeneralin Michael Oberneyer me zhvillimet e BMO-së



Prishtinë, 20 gusht - Në Brigadën Mbështetëse Operacionale (BMO) dje ka qëndruar për vizitë drejtori i NLAT-it (Ekipi Këshillues dhe ndërlidhës i NATO-s), gjeneral brigade Oberneyer, i cili u prit nga gjeneral brigade Naim Haziri. Gjatë këtij takimi të dy gjeneralët biseduan për periudhën e tranzicionit, nëpër të cilën është duke kaluar FSK-ja gjatë këtyre ditëve, si dhe për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. Gjithashtu, gjeneral Naim Haziri e njoftoi gjeneralin Oberneyer për aktivitetet aktuale të BMO-së; si për aktivitetet në fushën e kërkim-shpëtimit, në fushën e deminimit, për projektet xheniere si dhe për vizionin e tij për të ardhmen e këtij brigade.

Nga ana e tij, gjenerali Oberneyer e falënderoi gjeneralin Haziri për mirëpritjen dhe e përgëzoi për punën e deritanishme që BMO-ja po bën në mbështetje të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Përfundon trajnimi „Përcaktimi i zonës së aterrimit të helikopterit“ në Qendrën e Trajnimit për Kërkim Shpëtim



Pomozotin, 5 gusht 2019 - Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim Shpëtim të Regjimentit të Mbrojtjes Civile në kazermën „Evropianët e Rinj“ në Pomozatin, u mbajt ceremonia e certifikimit të kursit „Përcaktimi i zonës së aterrimit të helikopterit“. Shefi i Shtabit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile, nënkolonel Shpend Zogaj u shpreh shumë i kënaqur që Qendra e Trajnimit po arrin të përmbushë gradualisht vizionin për një Qendër me perspektivë rajonale dhe më gjerë.

Drejtori i QTKSH-së, tha se përdorimi i helikopterit ishte një element shumë i rëndësishëm i ndërveprimit dhe njohurive të NATO-s, dhe një aftësi e tillë ka qenë më se e nevojshme për një mbështetje operacionale ndërkombëtar potenciale e FSK-së në të ardhmen. Në këtë trajnim u trajtuan tema që lidhen me aerodinamikën dhe funksionimin e helikopterëve. Në veçanti, studentet u njoftuan me kriteret e përzgjedhjes së një zone të përshtatshme për aterrim të helikopterëve, me komandat dhe sinjalet e komunikimit me pilotin para aterrimit, si dhe mënyrën e evakuimit mjekësor duke përdorur formatin e kërkesës së quajtur „NATO nëntë linjat“. Po ashtu, studentet mësuan parimet themelore të bartjes së viktimave me helikopter.

Pjesë kyçe të këtij trajnimi ishin njohuritë e sjella nga pilotet e FSK-së, togerët Afrim Zabeli, Krenar Voca dhe Atdhe Hasani nga Komanda e Forcave Tokësore. Ata me ekspertizën e pilotimit të helikopterit sollën njohurit e tyre të dobishme rreth aerodinamikës së fluturakeve– helikopterëve. Gjithashtu, oficerët pilotë, në detaje ofruan njohuritë e tyre rreth procedurave që duhet ndjekur për të përcaktuar një zonë për aterrim të helikopterit. Edhe pse temat e trajtuara janë të një spektri më të gjerë, studentet arritën që për një kohë shumë të shkurtër të pajisen me njohuri themelore rreth përcaktimit të zonës së aterrimit varësisht nga zona ku ata mund të jenë caktuar për të operuar.

Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim është model jo vetëm në Forcën e Sigurisë së Kosovës, por edhe në rajon, për gjithë-përfshirjen e njerëzve që me të vërtetë sjellin diçka të mirë dhe të dobishme në kuadër të zhvillimit profesional.

FSK-ja pjesë e ushtrimit shumëkombësh në Gjermani



pjesëtarë që nga 9 gushti është duke marrë pjesë në ushtrimin fushor „Zgjidhja e Kombinuar XII“ (Combined Resolve XII), në bazën e Ushtrisë Amerikane për Evropë (USAREUR) që gjendët në Republikën Federale të Gjermanisë. Ekipi i FSK-së në këtë ushtrim është duke mbështetur Brigadën e Parë të Blinduar Luftarake të Divizionit të Këmbësorisë, në fushën e komunikimit, të personelit, të operacioneve si dhe në fushën e vëzhgimit dhe kontrollimit të zhvillimit të stërvitjes. Gjatë këtyre ditëve të ushtrimit, janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme në ngritjen dhe zhvendosjen e ritransmetuesve, sipas nevojave në mbështetje të operacioneve taktike të Batalionit të Parë Xhenier si dhe bashkëpunimit me Kompaninë e Komunikimit „Charlie“. Ushtrimi „Combined Resolved XII“, është ushtrim shumëkombësh i operacioneve të unifikuara tokësore, i drejtuar nga shtabi i Departamentit të Ushtrisë së SHBA-ve.



Qëllimi i këtij ushtrimi është stërvitja e forcave të caktuara rajonale të Shteteve të Bashkuara të nivelit të Brigadës, në mbështetje të objektivave të Komandës Evropiane të SHBA-ve për bashkëpunim dhe siguri, ndërtimin e gatishmërisë me aleatët dhe partnerët e NATO-s.

FSK-ja mbështet organizatat joqeveritare „TOKA“

Prishtinë, 20 gusht 2019 - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht Kompania për Operacione me Civil (KOC), në vazhdën e aktiviteteve të saj mbështetëse, gjatë muajit korrik ka përzgjedhur që të mbështesë organizatën joqeveritare (OJQ) „TOKA“ në organizimet e saj për zhvillimin e të rinjve, siç janë “Kampi Ndërkombëtar“ dhe „Kampi i Mbijetesës - Go Wild“. Pjesëtarët e FSK-së e kanë ndihmuar organizatën joqeveritare „TOKA“ në realizimin e projektit për aftësimin e gjeneratave të reja, duke i pajisur të rinjtë pjesëmarrës në këto kampe me njohuri të shumta në tema të ndryshme si: Orientimi në natyrë, ndihma e parë, ndërtimi i ekipit etj.

Forca e Sigurisë së Kosovës është angazhuar në vazhdimësi në dhënien e ndihmës profesionale për zhvillimin e gjeneratave të reja, si në aspektin profesional dhe aftësimin për jetë, ashtu edhe në aspektin e krijimit të një shoqërie mendjehapur, pa dallime gjinore, etnike dhe fetare. Të rinjtë që ishin pjesë e këtyre kampeve rinore shprehën mjaft falënderues për FSK-në, në veçanti për ndihmën e saj të pakursyer dhe profesionale gjatë realizimit të temave të ndryshme në natyrë.



FSK-ja dhe OJQ „PLAY2EDUCATE“ realizojnë seksionin veror të futbollit

Prishtinë, 15 gusht 2019 - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht Kompania për Operacione me Civilë (KOC), ka mbështetur organizatën joqeveritare „PLAY2EDUCATE”nga Mitrovica për realizimin e sesionit veror të futbollit. Kompania për Operacione me Civilë e FSK-së ka bashkërenduar aktivitetet me organizatën joqeveritare „PLAY2EDUCATE për realizimin e kësaj ngjarjeje. Pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë ish-nxënësit / pjesëmarrësit e programit „Fuqizimi përmes lojës–Empowerment thru play“ dhe pjesëtarët e Batalionit të Tretë të BRSH-së. Ky aktivitet është organizuar me qëllim të forcimit të raporteve mes të rinjve dhe aktorëve të sigurisë me qëllimin të ndërtimit të një mjedisi sa më të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim.




FSK-ja gjeti trupin e pa jetë të Shaban Shabanit në liqenin e Batllavës



Prishtinë, 29 gusht 2019 - Sot në orën 18:20, në liqenin e Batllavës, njësia e Kërkim-Shpëtimit në Ujëra e FSK-së, në bashkëpunim edhe me Policinë e Kosovës gjetën trupin e pa jetë të të ndjerit Shaban Shabani 55 vjeçar nga komuna e Obiliqit.

Me vendim të Ministrit të Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha dhe me urdhër të Komandantit të FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, pjesëtarët e Kompanisë së Kërkim-Shpëtimit në Ujëra të Forcës së Sigurisë të Kosovës, që nga 25 gushti, kanë marrë pjesë në operacionin për kërkimin e personit të mbytur në Liqenin e Batllavës.

















FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 84 • 10 Tetor 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Komandanti i ri i Gardës Kombëtare të Ajovës qëndroi për vizitë zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes të Kosovës





Prishtinë, 23 SHTATOR - Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Burim Ramadani dhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën sot në takime të ndara komandantin e ri të Gardës Kombëtare (GK) të Ajovës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), gjeneral majorin Benjamin Corell. Në takimin e zëvendësministrit Ramadani me gjeneralin amerikan Corell, ishte i pranishëm edhe ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm Faruk Geci, u bisedua për partneritetin e suksesshëm dhe konkret ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes/ FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës në kuadër të partneritetit shtetërorë ndërmjet Kosovës dhe Ajovës. Zoti Ramadani e falënderoi gjeneralin Corell dhe përmes tij Gardën Kombëtare dhe shtetin e Ajovës për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, si dhe e njoftoi lidhur me procesin e tranzicionit dhe implementimin e Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, në mënyrë që FSK-ja si institucioni të jetë sa më i gatshëm për ngrijën e kapaciteteve të saj, si dhe të zhvillohet në atë nivel që të jetë i ndërveprueshëm me institucionet e tjera partnere, dhe në një të ardhme të jetë kontribuuese e paqes globale.

Në takimin e parë zyrtar në Ministrinë e Mbrojtjes ndërmjet komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral major Benjamin Corell u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera të Forcës së Sigurisë të Kosovës me Gardën Kombëtare të Ajovës, si dhe për gatishmërinë e dy institucioneve për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Gjenerali Rama dhe gjenerali amerikan Correl pritet që nesër të zhvillojnë vizitë në Gardën Kombëtare të FSK-së në Pomozotin si dhe repartet dhe njësitë e Gardës Kombëtare. Gjeneral Rama dhe gjenerali Corell së bashku pritet të marrin pjesë në takimin e radhës të shefave të Mbrojtjes në kuadër të Konferencës SHBA-Karta e Adriatikut (A5) që do të mbahet në Republikën e Shqipërisë.

Në përkujtim të viktimave të sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001

Ministri Berisha mori pjesë në zbulimin e Pllakës memoriale të sulmit terrorist në SHBA



Prishtinë, 11 SHTATOR - Sot, me rastin e zbulimit të pllakës memoriale „Kosovo Remembers“ (Kosova kujton) të ngritur në oborrin e Qeverisë së Kosovës, në shenjë nderimi të viktimave të sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, morën pjesë ministri dhe zëvendësministri i Mbrojtjes në detyrë, Rrustem Berisha dhe Kadri Kastrati, zv. komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, gjeneral Gëzim Hazrolli, gjeneral Fadil Hadërgjonaj, gjeneral Nazmi Brahimaj, gjeneral Xhevahir Geci, si dhe Njësia Ceremoniale e Gardës së Kosovës. Pllakën memoriale e zbuluan kryeministri në detyrë Ramush Haradinaj dhe ambasadori i SHBA-ve në Kosovë Philip Kossnet, në të cilën është gdhendur logoja e Qeverisë së Kosovës dhe fjalët „Kosovo Remembers“ (Kosova kujton) si dhe data 11 shtator 2001. Pas zbulimit të pllakës memoriale pjesëmarrësit bënë homazhe në shenjë nderimi dhe përkujtimit të viktimave në SHBA.

Gjeneral Rama priti gjeneralin Phillips nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë



Prishtinë, 17 SHTATOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti sot në vizitë në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneral brigade John Phillips, zv. shef i Departamentit të Komunikimit në kuadër të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë. Në takimin e përbashkët, komandanti i FSK-së dhe gjenerali amerikan, biseduan për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Kosovës dhe SHBA-ve, përkatësisht Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, në fusha konkrete dhe bashkëpunime të frytshme.

Me këtë rast, gjeneral Rama vlerësoi lart rolin e trupave ushtarake amerikane në kuadër të KFOR-it, marrëdhëniet dypalëshe me Gardën Kombëtare të Ajoves, donacionet e pareshtura të Qeverisë dhe popullit amerikan për zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së, si dhe ngritjen e kapaciteteve të saj.

Gjatë takimit të dy gjeneralët biseduan edhe për sigurinë kibernetike, shkëmbimin e përvojave në mes dy ushtrive dhe në veçanti folën për objektivat e FSK-së dhe të Kosovës për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të fushës kibernetike, funksionalizimin e sistemit të sigurisë kibernetike në përballje me kërcënimet eventuale si në vend, ashtu edhe në rajon dhe me gjerë, bashkëpunimin me shtetet mike dhe partnere etj.

Gjenerali Phillips së bashku me stafin e tij, vizitoi edhe Kompaninë e Komunikimit, ku nga kapiteni Fatmir Kajtazi u njoftua në pika të shkurtra rreth detyrave, pajisjeve dhe misionit të kompanisë që ai drejton. Më pas, të gjithë se bashku ndoqën trajnimet e pjesëtarëve të FSK-së, në fushën e IT-së (Cyber TCT) dhe në fushën e radiosistemeve, të cilat janë duke u realizuar falë bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në konferencën e 23-të „Karta e Adriatikut - A5“ në Durrës



Prishtinë, 26 SHTATOR - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, mori pjesë në konferencën e shefave të mbrojtjes „Karta e Adriatikut A5“, e cila u mbajt në Durrës. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama në këtë konferencë udhëtoi nga Kosova së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajorin Benjamin Corell.

Konferenca i zhvilloi punimet nga data 24-26 shtator 2019, e që kishte për qëllim që të sinkronizojë të gjitha aktivitetet trajnuese por edhe ushtrimet e përbashkëta ndërmjet shteteve anëtare, përfshirë dhe EUCOM-in, në ngritjen e gatishmërisë dhe përmirësimin e ndërveprimin gjatë operacioneve të përbashkëta për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon. Gjithashtu qëllim tjetër i rëndësishëm i kësaj iniciative rajonale është edhe mbështetja e shteteve që aspirojnë integrimin në NATO.

Gjenerali Rrahman Rama gjatë kësaj konference, pati rastin që t'ju drejtohet të gjithë pjesëmarrësve; duke theksuar në veçanti procesin e tranzicionit, si dhe të arriturat e FSK-së. Ai ndër të tjera shtoi se FSK-ja po vazhdon t’i ngritë kapacitetet e saj sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, dhe se mbështetja e partnereve strategjikë gjatë këtij procesi shumë të rëndësishëm. Për më tepër, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, tha: „FSK-ja si forcë e ndërtuar dhe e zhvilluar me standarde të NATO-s, është e gatshme që t’i marrë përsipër të gjitha obligimet që dalin nga anëtarësimi në „Kartën e Adriatikut-A5“, për të ndër vepruar dhe kontribuar me kapacitetet e saj për paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë“. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë konferencës ka zhvilluar takime dypalëshe me zv. komandantin e EUCOM-it, gjenerallejtënant Stephen Twitty, si dhe me kryesuesit e delegacioneve të vendeve pjesëmarrëse në konferencë. Temë diskutimi gjatë këtyre takimeve ka qenë avancimi i bashkëpunimit në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të FSK-së, aktivitetet e përbashkëta trajnuese, por gjithashtu edhe ofrimi i kapaciteteve trajnuese të FSK-së për zhvillim profesional të kapaciteteve të partnereve tanë. Gjeneral Rama, gjithashtu, i falënderoi të gjitha shtetet anëtare të Kartës së Adriatikut A5, për përkrahjen e vazhdueshme në ndërtimin dhe forcimin e partneritetit, i cili e ndihmon jo vetëm Forcën e Sigurisë së Kosovës por të gjithë Kosovën.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës vizitoi Gardën Kombëtare të FSK-së



Prishtinë, 25 SHTATOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajori Benjamin Corell u pritën nga komandanti i Gardës Kombëtare i FSK-së, gjeneral brigade Xhevahir Geci, gjatë vizitës në kazermën „Evropianët e rinj’’ në Pomozotin. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama rikonformoi mbështetjen e tij të pakursyer për ngritjen sa më të shpejtë të Gardës Kombëtare të FSK-së, duke u bazuar në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit.

Gjenerali Xhevahir Geci e njoftoi komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës për fillimin e ngritjes të Gardës Kombëtare të FSK-së, e cila do të bazohet në modelin e ushtrisë amerikane, si dhe për misionin dhe strukturën e Gardës Kombëtare. „Ne, me kapacitetet që kemi, jemi të gatshëm që në çdo moment t’i dalim në ndihmë popullatës së Republikës të Kosovës dhe vendeve fqinje të rajonit kurdo që kërkohet nga institucionet shtetërore. Gjithashtu presim nga ekspertët e Gardës Kombëtare të Ajovës të na mbështesin me eksperiencat e shumta që kanë në mënyrë që të kemi performansë sa më të mirë në mbrojtje të jetëve dhe pasurisë së qytetarëve tanë”, - tha gjeneral Geci.

Ndërsa, koloneli Shaip Haziri, njoftoi për kapacitetet, aktivitetet dhe operacionet e Regjimentit të Mbrojtjes Civile të Gardës Kombëtare. Kolonel Haziri u shprehu falënderim për Qeverinë e SHBA-ve për mbështetjen e vazhdueshme me donacione për RMC-në. Kurse, komandanti i Qendrës Trajnuese të Kërkim-Shpëtimit, John Doone para gjeneralëve mbajti një takim të shkurtër informues rreth aktiviteteve të kësaj njësie.

Me këtë rast komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Corell e falënderoi komandantin e GK-së të FSK-së, gjeneral Gecin, për pritjen dhe informacionet e detajuara gjatë këtij takimi. Të pranishmit realizuan një vizitë në mjediset e kazermës së GK-së, për të parë nga afër poligonin e Qendrës Trajnuese për Kërkim-Shpëtim si dhe stacionet dhe pajisjet specialistike të KKSH-së dhe MKABK-së. Nga të dyja palët u vlerësua lart profesionalizmi i i FSK-së, si dhe u pajtuan që ky bashkëpunimin mjaft i mirë me Gardën Kombëtare të Ajovës të vazhdojë edhe në të ardhmen.

FSK-ja përkujtoi 18-vjetorin e sulmeve terroriste në SHBA



Prishtinë, 11 SHTATOR - Oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, të rreshtuar në kuadrate së bashku me ushtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës (të ndodhur për vizitë në FSK) dhe oficerë të SHBA-ve që veprojnë në NALT (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s) në kuadër të misionit në FSK, u rreshtuan sot në kazermën „Adem Jashari“ dhe në të gjitha kazermat e FSK-së, për të nderuar viktimat e sulmit terrorist të 11 shtatorit të vitit 2001, të ndodhur në kullat binjake në Nju Jork, ku humbën jetën mijëra civilë të pafajshëm. Ceremonia përkujtimore u kryesua nga zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral majori Enver Cikaqi.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma “Adem Jashari”, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Gjermania i dhuroi një grand prej 500 mijë eurosh Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës



Prishtinë, 19 SHTATOR - Sot në Ministrinë e Mbrojtjes z. Faruk Geci, ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Christian Heldt, ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë, nënshkruan Marrëveshje me anë të së cilës Qeveria gjermane ndan një grand në vlerë 500,000€ (pesëqind mijë euro) për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për blerjen e materialeve dhe pajisjeve mjekësore. Me këtë rasat, sekretari i përgjithshëm z. Geci ka falënderuar ambasadorin gjerman, z. Heldt dhe përmes tij Qeverinë dhe popullin gjerman për ndarjen e mjeteve financiare për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht për shërbimin mjekësorë të FSK-së, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme që Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë është duke dhënë për ndërtimin e kapacitetet të FSK-së. Forca e Sigurisë e Kosovës me fondin e dhuruar nga Qeveria gjermane, ka për qëllim të përmirësojë pajisjet e Qendrës Mjekësore të saj, si dhe synon të sigurojë materiale dhe pajisje mjekësore që do të ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve mjekësore dhe shërbimeve mjekësore në FSK. Ministria e Mbrojtjes e Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë kanë marrëdhënie shumë të mira dypalëshe.

Me urdhër të Komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës

Garda Kombëtare e FSK-së filloi ngritjen e kapaciteteve



Prishtinë, 24 SHTATOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në një ceremoni zyrtare, ka urdhëruar fillimin e ngritjes së Gardës Kombëtare sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit. Mbajtja e Aftësive Ekzistuese, të cilat deri me tani ishin në vartësi të Brigadës së Mbështetjes Operacionale, kanë kaluar nën komandimin dhe kontrollin e Gardës Kombëtare të udhëhequr nga gjeneral Xhevahir Geci, ndërsa Brigada e Mbështetjes Operacionale ka kaluar në Komandë të Logjistikës në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, nën komandimin e gjeneral Naim Hazirit. Kjo është dëshmi se FSK-ja po vazhdon me ngritjen dhe riorganizimin e njësive sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit. Garda Kombëtare e FSK-së është njësi vartëse e Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së. Në misionin e ri do të mbajë dhe do të zhvillojë aftësitë operacionale në kuadër të Mbështetjes Ushtarake për Autoritetet Civile. Gjeneral Rama dhe gjeneral Haziri i uruan komandantit të Gardës Kombëtare, gjeneral Gecit, punë të mbarë dhe suksese në detyrën e re.

Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar vizitoi Qendrën e Trajnimit të Kërkim- Shpëtimit të FSK-së

Prishtinë, 17 SHTATOR - Sot, ambasador i Britanisë së Madhe në Republikën e Kosovës, z. Nicholas Abbott, vizitoi Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në kazermën „Evropianët e Rijnë“ në Pomozatin, me ç'rast u mirëprit nga shefi i Shtabit i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), nënkolonel Shpend Zogaj, i cili e njoftoi atë, me të arriturat e përgjithshme të këtij regjimenti si dhe vizionin për të ardhmen. Ambasadori Abbot, gjatë kësaj vizite takoi studentët pjesëmarrës të trajnimit „Menaxhimi i Rrezikut nga Trauma“ si dhe vizitoi objektet e QTKSH-së: kornizën e helikopterit; vagonët e trenit; ndërtesat e shembura dhe gjysmë të shembura; zonën e përplasjes masive të trafikut dhe kullën e lartë të ushtrimeve.

Ambasadori Abbot, gjatë vizitës së tij, nga shefi i qendrës së trajnimit u informua rreth planeve për ndërtimin e infrastrukturës së QTKSH-së, për ta bërë një qendër të kompletuar për trajnime të kërkim-shpëtimit, jo vetëm për pjesëtarët e FSK-së, por edhe të rajonit dhe më gjerë. Nga ana e tij, ambasadori Abbot, vlerësoi QTKSH-në, për gjithçka që ka arritur deri me tash dhe veçanërisht për vizionin e saj për të ardhmen. Ai gjithashtu premtoi vazhdimin e mbështetjes së Mbretërisë së Bashkuar për FSK-në dhe QTKSH-në.

FSK-ja merr pjesë në ushtrimin ndërkombëtar „Saber Junction 19“ në Gjermani



Prishtinë, 24 SHTATOR - Një kontingjent i Forcës së Sigurisë të Kosovës i përberë nga oficerë dhe nënoficerë, dy ekipe mjekësore dhe një ekip i Kompanisë për Operacione Civile (KOC), që nga 10-30 shtator po merr pjesë në ushtrimin fushor ndërkombëtar „Saber Junction 19“ , i cili po realizohet në bazën amerikane „Hohenfels“ të Gjermanisë.

Pjesëtarët e kontingjentit të FSK-së i janë bashkua njësive amerikane, sipas misionit të tyre, duke operuar në detyrat e tyre specifike. Krahas Divizionit të Parë të Këmbësorisë së ushtrisë amerikane dhe asaj të Kosovës, në këtë ushtrim po marrin pjesë edhe mbi 5400 trupa nga shumë vende të botës, si: Armenia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Italia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Polonia, Rumania, Turqia dhe Ukraina. Ekipet e mjekësisë të FSK-së janë angazhuar në trajtimin e të lënduarve, evakuimin e viktimave dhe mbështetje të tjera mjekësore. Ndërsa, ushtarakët e KOC-it janë duke realizuar operacione me civilët. Si njësi e re e krijuar, gjatë operacioneve të këtij ushtrimi, janë mbështetur vazhdimisht nga ekipet e specializuara në fushën e operacioneve civile të ushtrisë amerikane. Gjatë ushtrimit është mbajtur edhe DV-Day. Nga FSK-ja, ushtrimin e përcollën kolonelët Agron Bajrami dhe Gyrner Murati. Ushtrimi kishte për qëllim demonstrimin e aftësive dhe të gatishmërisë për të vepruar dhe punuar në një mjedis të kombinuar shumëkombësh, si dhe shkëmbimin e përvojave me shtetet partnere.

Në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë

Kadetët e rinj të FSK-së solemnisht dhanë betimin

Prishtinë, 26 SHTATOR - Në repartet e kazermës „Adem Jashari“ të Shtabit të Përgjithshëm të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë, sot u zhvillua ceremonia e betimit e rekrutëve të rinj, gjenerata 2023, të cilët filluan vitin akademik 2019/20 në Qendrën për Studime Universitare të Akademisë së Mbrojtjes. Në ceremoni ishin të pranishëm: ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, zv. ministri Kadri Kastrati, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm Faruk Geci, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s, gjenerali Michael Obernayer, gjeneralë, oficerë të FSK-së dhe NALT-it, si dhe familjarë e miq të rekrutëve të rinj. Pas rreshtimit, inspektimit dhe intonimit të himnit shtetëror, fjalën e rastit e mbajti ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, i cili këtë gjeneratë të rekrutëve e cilësoi si gjeneratën më me fat: ,,Kjo është një datë me rëndësi për FSK-në. Ju jeni gjenerata e parë e kadetëve që keni nderin t'i bashkoheni FSK-së me mandat të ri ushtarak. Sot, duhet të jeni krenarë për arritjet tuaja dhe të zotoheni që gjithmonë do ta



nderoni uniformën e FSK-së, ta nderoni atdheun, t'i respektoni eprorët tuaj dhe ta mbroni paqen, lirinë dhe shtetin tonë“. Në fund të fjalës së tij, ministri Berisha deklaroi: ,,Si Ministër i Mbrojtjes, jam krenar me vajzat dhe djemtë tanë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, të cilët me sukseset e tyre në shkollat dhe trajnimet e përfunduara nëpër akademi të ndryshme të vendeve të NATO-s, kanë treguar performansë të shkëlqyer dhe kanë përfaqësuar me nder FSK-në. Pres që edhe ju ta ndiqni shembullin e tyre“. Gjithashtu komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, tha se programi i edukimit dhe trajnimit të kadetëve/oficerëve është i bazuar në dy komponente, atë akademik të cilën e marrin në Universitetin Amerikan të Kosovës dhe komponentin e udhëheqjes së trupave, të cilin e ofron Qendra për Studime Universitare, njëra nga 5 qendrat e KDS-së, përmes stafit të instruktorëve më të përgatitur profesionalisht“. Në fund të ceremonisë, 14 rekrutët e rinj, para komandantit të QSU-së majorit Vegim Krelani dhe të pranishmëve të tjerë, solemnisht dhanë betimin si kadetë të FSK-së dhe nënshkruan kontratat për shërbim në FSK.





Gjenerata e parë e kadetëve të FSK-së festojnë 10-vjetorin e diplomimit

Prishtinë, 23 SHTATOR - Kadetët e Gjeneratës së parë të Qendrës për Studime Universitare
tani më oficerë të Forcës së Sigurisë të Kosovës kremtuan sot 10-vjetorin e diplomimit të kësaj gjenerate. Në këtë ceremoni të pranishëm ishin: ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, zv. ministri Burim Ramadani, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm Faruk Geci, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, gjeneralë të FSK-së, ish-komandantë të QSU-së, si dhe oficerë dhe kadetë të FSK-së. Me këtë rast, të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama: „Forca e Sigurisë e Kosovës me sukses ka arritur të zhvillojë sistem të rekrutimit, shkollimit dhe trajnimit të kuadrove të reja dhe se pikërisht sistemi i tillë serioz dhe i përkushtuar ka bërë që FSK-ja sot të krenohet me oficerët e rinj, si garantuese e vazhdimësisë së suksesshme të institucionit tonë. Qendra për Studime Universitare e FSK-së së shpejti do të jetë ndërkombëtare, ku do të kenë mundësi të shkollohen edhe kadetë nga shtetet mike dhe partnere, - u shpreh ndër të tjera gjeneral Rama. Gjithashtu edhe gjeneral Spahiu i përgëzoi oficerët e FSK-së, të diplomuar para dhjetë vitesh si dhe të gjithë oficerët e rinj të diplomuar më pas, duke i porositur që të vazhdojnë të shërbejnë me nder, zell e përkushtim, ashtu siç edhe janë përgatitur dhe zotuar gjatë shkollimit të tyre. Të pranishmit me një fjalë rasti i përshëndeti edhe ish-komandanti i QSU-së, Valon Ahmeti, njëri nga oficerët e parë të diplomuar në SHBA dhe ideator i atëhershëm për ngritjen e Qendrës për shkollimin e kadetëve për shërbim, atëherë si oficerë në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, e pas vitit 2009 në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Gjatë kësaj ceremonie, u shfaq edhe një dokumentar i shkurtër me disa nga momentet sfiduese të kadetëve, gjatë katër viteve të studimit në këtë Akademi, të cilat kanë ngelur ende në kujtesë të kadetëve të kësaj gjenerate. Në nderim të shkollës së QSU-së, kadetët kanë planifikuar të realizojnë „Javën e QSU-së“ , e cila do të shënohet me ceremoni dhe aktivitete të shumta që do realizohen gjatë kësaj javë. Hapja e kësaj jave u bë sot në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë, ku u mbajt ceremonia kryesore e këtij manifestimi, në të cilën të pranishëm ishin krerët e lartë të FSK-së, si dhe mysafirë specialë, që kishin ardhur t'i nderojnë kadetët e Gjeneratës së parë dhe QSU-në në përgjithësi. Më pas, të gjithë së bashku mbollën fidanë para Objektit të ri të Qendrës për Studimeve Universitare, në shenjë nderimi dhe respekti për të gjithë oficerët që kanë dalë dhe për ata që janë duke dalë nga kjo qendër.








Gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në Panairin e Industrisë Ushtarake në Londër

Prishtinë, 13 SHTATOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të organizatorit të Panairit të Industrisë Ushtarake (DSEI), nga data 09-12 shtator 2019, qëndroi për vizitë zyrtare në Londër. Panairi i industrisë ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar konsiderohet si njëri ndër panairet më të mëdha në botë. Gjenerallejtënant Rrahman Rama, në kuadër të këtij panairi, ka mbajtur takime edhe me zëvendëskomandantin e Komandës së Asistencës të Sigurisë të Ushtrisë Amerikane, Robert Moore, ku së bashku kanë biseduar për shumë çështje të rëndësishme për FSK-në, si për procesin e tranzicionit, planet për ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive të reja mbrojtëse, si dhe për mbështetjen që Komanda e Asistencës së Sigurisë e Ushtrisë Amerikane do të mundë të ofrojë në të ardhmen për FSK-në. Po ashtu, gjeneral Rama është takuar edhe me gjeneral majorin Chris Tickel, drejtor i Aftësive në kuadër të Ushtrisë Britanike, të cilin, veç tjerash, e ka njoftuar lidhur me kapacitetet aktuale të FSK-së dhe integrimin e kapaciteteve të reja sipas planit gjithëpërfshirës të tranzicionit. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë takimit u shprehë se: FSK-ja po vazhdon ndërtimin e kapaciteteve profesionale ushtarake, bazuar në standardet më të larta, për t'i kontribuar sigurisë në bashkëveprim me partnerët e saj strategjikë.



Komandanti i Kompanisë të EOD-së të Ushtrisë Amerikane vizitoi EOD-në e FSK-së



Prishtinë, 05 SHTATOR - Kompania e Deminimit e Forcës së Sigurisë të Kosovës ka një bashkëpunim të shkëlqyer me Trupat Amerikane në Kosovë. Puna dhe bashkëpunimi i tyre në baza ditore ka dhënë rezultate të shkëlqyera në shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy ekipeve të EOD-së. Dje në mjediset e Kompanisë së Deminimit qëndroi për vizitë komandanti i Kompanisë 702 i EOD-së i Ushtrisë Amerikane, kapiteni Xhordan Smith së bashku me rreshterin e parë të kompanisë Konley. Ata u pritën nga stafi udhëheqës i Kompanisë së Deminimit të FSK-së, major Gëzim Sada dhe zyrtari i NALT-it, nënkolonel Todd Essing. Së pari, Trupat Amerikane të EDO-s u njoftuan për punën dhe sukseset e deritanishme të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, nga komandanti i kësaj kompanie, major Gëzim Sada. Më pas, në fshatin Harilaq të dy ekipet e EOD-së organizuan një aktivitet të përbashkët, ku demoluan mina dhe mjete të tjera shpërthyese të gjetura nga ekipet e deminimit të FSK-së.

Komandantët e të dy EOD-ve u zotuan për vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

Oficerë të Gardës Kombëtare të Ajovës vizitojnë FSK-në



Prishtinë, 19 SHTATOR - Një delegacion, prej 50 oficerësh dhe nënoficerësh të „Staff Ride“ të Gardës Kombëtare të Ajovës, nga data 16-20 shtator 2019, qëndruan për vizitë zyrtare në Kosovë. Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni „Staff Ride“ nga Ajova së bashku me oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, kanë vizituar disa vende historike dhe të rëndësishme të Republikës së Kosovës, si dhe kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme akademike dhe rekreative. Oficerët amerikanë së pari kanë vizituar kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë, si dhe Qendrën për Studime Universitare, Policinë e Forcës, Kompaninë e Mjekësisë, Batalionin e Xhenios dhe atë të Logjistikës. Vizitorët janë njoftuar me kapacitetet e njësive, aktivitetet dhe angazhimin e tyre, kapacitetet ekzistuese të FSK-së dhe planifikimet e fazës së tranzicionit. Më pas, oficerët amerikanë kanë vizituar edhe disa vende historike si: qytetin e lashtë „Dodona“, Manastirin e Graqanicës, Krushën e Madhe, Gazimestanin, Prishtinën, Prizrenin dhe Gjakovën, si dhe disa vende me rëndësi historike e kulturore. FSK-ja ka organizuar edhe lojë miqësore në futboll ndërmjet Ekipit të FSK-së dhe atij të „Staff Ride“ të Gardës Kombëtare të Ajovës, e cila u zhvillua në stadiumin „Fadil Vokrri“ në Prishtinë. Vizita e delegacionit të Gardës Kombëtare të Ajovës, u zhvillua në kuadër të Programit të Partneritetit Shtetëror që ka Kosova me Shtetin e Ajovës. Kjo vizitë përveç njohjes nga afër ka për qëllim edhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës.

Policia Ushtarake e FSK-së trajnohet nga Policia e Kosovës

Prishtinë, 19 SHTATOR - Në kuadër të bashkëpunimit të Policisë Ushtarake të Forcës së Sigurisë të Kosovës me Policinë e Kosovës, nga data 16 deri më 19 shtator, në kazermën „Adem Jashari“ është realizuar trajnimi „Taktikat mbrojtëse për polici“. Trajnimi është mbajtur nga instruktorët e Policisë së Kosovës, të cilët personelin e Policisë Ushtarake të FSK-së e kanë aftësuar për përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve policore. Gjatë trajnimit pjesëtarët pjesëmarrës janë aftësuar lidhur me teknikat dhe taktikat e përdorimit të armëve të brezit dhe procedurat ligjore për përdorimin e tyre. Të gjithë pjesëtarët e Policisë Ushtarake, të cilët e kanë përfunduar me sukses këtë trajnim, janë certifikuar. Ky certifikim është mjaft i rëndësishme dhe do të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve për ndërveprim që Forca e Sigurisë e Kosovës synon të arrijë me Policinë e Kosovës

Në Brigadën e Reagimit të Shpejtë u mbajt gara „Ujku Garues 2019”



Prishtinë, 20 SHTATOR - Pjesëtarët e Kompanisë së Taskë Forcës së Kërkim-Shpëtimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në bazë të Planit të trajnimeve dhe aktiviteteve për vitin 2019, kanë realizuar marshimin kondicional „Gjeravica 2019“ mbi 15 km të gjatë. Marshimi i njësisë së forcës operative u realizua në kushte jo të mira atmosferike, në një lartësi mbidetare prej 2656 metrash, nga „Bjeshkët e Junikut“ deri në majën e malit „Gjeravica“. Marshimi kishte për qëllimi përgatitjen fizike të pjesëtarëve të FSK-së në përballje me sfidat. Të gjithë pjesëtarët e kësaj kompanie arritën që me sukses të realizojnë këtë marshim mjaft sfidues.

Në Ministri të Mbrojtjes

U mbajt seminari: Roli i menaxherëve të kontratave dhe rëndësia e hulumtimit të tregut



Prishtinë, 13 SHTATOR - Në Ministrinë e Mbrojtjes u mbajt seminari dy ditorë për stafin ushtarak dhe civil të Ministrisë dhe FSK-së me temë: „Roli i menaxherëve të kontratave në ekzekutimin e kontratave dhe rëndësia e hulumtimit të tregut“ të organizuar nga Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s (NALT) dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Në hapjen e punimeve të punëtorisë mori pjesë ushtruesi i detyrës së Sekretarit të përgjithshëm Faruk Geci si dhe Christian Boatswain, zëvendës drejtor i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s. Z. Geci çmoi lartë rëndësinë e këtij seminari si dhe rolin e NALT-it në organizimin e tij, sepse pa një edukim dhe specializim të menaxherëve të kontratave nuk mund të ketë as menaxhim dhe mbarëvajtje të mirë të kontratave me kontraktorët e Ministrisë së Mbrojtjes. Efikasiteti i menaxherëve të kontratave në menaxhimin e kontratave do të ndikojë edhe në ekzekutimin e kontratave me sukses. Gjithashtu edhe zv. drejtori i NALT, z. Christian Boatswain e konsideroj si sukses organizimin dhe mbajtjen e seminarit mbi Rolin e menaxherëve të kontratave në ekzekutimin e kontratave dhe se kontributi i NALT-it në këtë lëmi do të jetë i vazhdueshëm edhe në të ardhmen.

Gjatë sesioneve dy ditore të seminarit ligjëruan, si: Afrim Maxhuni, drejtor i Prokurimit në MM për temën: „Raporti i Departamentit të Prokurimit në lidhje me vështirësitë në procesin e prokurimit (hulumtimi i tregut, vlera e kalkuluar, pasojat e hulumtimit të pasaktë të tregut), pastaj „Rëndësia e ndërmarrjes së hulumtimeve të sakta të tregut për procesin e prokurimit'' u ligjërua nga Klemen Stibelj (NALT) si dhe zonja Anela Duman si eksperte për prokurim publik në Qendrën për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes, etj. Seminari ishte interaktiv si dhe u zhvilluan diskutime në grupe. Në fund për personelin civil dhe ushtarak nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës u ndanë certifikata.

FSK-ja trajnon Policinë e Kosovës dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave



Prishtinë, 11 SHTATOR - Në kuadër të Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QTKSH) të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) është duke u realizuar trajnimi „Zhytje e avancuar“, ku po marrin pjesë pjesëtarët e Policisë së Kosovës (PK) dhe pjesëtarët e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME). Trajnimi ka filluar më 2 shtator dhe do të përfundojë më 20 shtator, dhe po realizohet në tri lokacione: Pomozotin, Liqenin e Batllavës dhe atë të Radoniqit. Instruktorët e specializuar të QTKSH-së janë duke e realizuar trajnimin me institucionet vendore të sigurisë, në mënyrë që së bashku t'i fitojnë njohuritë e nevojshme në fushën e kërkim–shpëtimit në ujëra, për të qenë të gatshëm dhe me ndërveprueshmëri institucionale, t'i përfundojnë me sukses detyrat në raste reale të fatkeqësive natyrore dhe atyre njerëzore. Në këtë trajnim, që përfshin pjesën teorike me 27 orë dhe pjesën praktike me 75 orë, testohen aftësitë në fusha të ndryshme që kapin elementin e zhytjes, si: zhytja dhe llojet e zhytjes; komunikimi nënujor; presioni dhe ligjet e fizikës; mjekësia e zhytjes; zhytja në izobat; zhytja në grup; zhytja në thellësi; menaxhimi nënujorë; zhytja natën; navigimi natën etj. Specifikat e zhytjes dhe kërkimit në ujëra kërkojnë vëmendje të madhe dhe disiplinë të fortë. Pakujdesia më e vogël mund të kushtojë me jetë, prandaj pjesa praktike ka një rol të veçantë dhe i kushtohet kujdes secilit detaj, duke filluar që nga veshja e uniformës, bombolat e ajrit, bashkërendimi me ekipin, pajisjet dhe gjithçka që ka të bëj me zhytjen.

Mbahet punëtoria „Përgatitjet para dislokimit“



Prishtinë, 12 SHTATOR – Në Forcën e Sigurisë së Kosovës po mbahet punëtoria „Përgatitjet para dislokimit/ Zhvillimi i nënoficerëve“, në të cilën po marrin pjesë 33 pjesëtarë të njësive të FSK-së. Punëtoria „Përgatitjet para dislokimit“, ka filluar më 09 shtator do të përfundojë më 13 shtator dhe u mundësua nga ekip i ekspertëve prej shtatë pjesëtarësh të Gardës Kombëtare të e Ajovës (SHBA). Gjatë këtyre ditëve, ekspertët nga SHBA-të ligjëruan tema nga më të ndryshmet rreth përgatitjeve para dislokimit si: Logjistika dhe furnizimi - procesimi i gatishmërisë së ushtarit; detyrat dhe përgjegjësitë e nënoficerit–procesimi i gatishmërisë së ushtarit; pasqyra e pjesës financiare dhe juridike; lista kontrolluese e gatishmërisë dhe zbarkimit etj. Pjesëtarët e FSK-së, të cilët morën pjesë në këtë punëtori, janë pajisur me njohuri të shumta, në të gjitha temat me interes lidhur me dislokimin, nga përvojat e instruktorëve të Ajovës. Ky trajnim po realizohet në kuadër të bashkëpunimit dypalësh që FSK-ja ka me Ajovën për ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së.

FSK-ja pjesë e ushtrimit ndërkombëtar „Albanian Effort 19” në Shqipëri



Shqipëri-BIZA, 09 SHTATOR – Ushtrimi „Albanian Effort 19“ mblodhi në Bizë rreth 800 efektivë nga Shqipëria, SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Kroacia, Polonia, Italia, Gjermania, Bullgaria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova. Në shtatë ditë përfaqësuesit ushtarakë nga 12 vende aleate dhe partnere treguan se cili është burimi i fuqisë së Aleancës më të madhe ushtarako - politike në botë.

Në ushtrimin „Albanian Effort 19“ kontingjent i FSK-së, me personel nga Brigada e Reagimit të Shpejtë, me një Togë të këmbësorisë, duke përfshirë oficerë shtaborë për Kontrollin e Lartë me shtab në terren dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes me vëzhgues kontrollues u dalluan për profesionalizimin e lartë gjatë kryerjes së ushtrimit.

Qëllimi i ushtrimit „Albanian Effort 19“ ishte ngritja e bashkëpunimit me njësitë partnere, ngritjen profesionale dhe testimin e aftësive të vendimmarrjes ushtarake në një mjedis shumëkombësh, për të testuar aftësitë e ndërhyrjes së përbashkët në kohë krizash.

FSK-ja merr pjesë në kampin ndërkombëtar të nënoficerëve në Kroaci



Prishtinë, 02 SHTATOR - Kampi veror ndërkombëtar i nënoficerëve, që ka filluar më 29 gusht dhe do të përfundojë më 6 shtator 2019, këtë vit po mbahet në Kroaci. Pjesëmarrës në këtë kamp janë ushtarakët nga vendet e NATO-s dhe nga vendet partnere. Qëllimi i kampit është që të përgatitën nënoficerët e lartë me shkathtësi të udhëheqjes dhe funksioni i tyre në operacione ndërkombëtare. Këtë vit FSK-ja po merr pjesë me dy nënoficerë: kapter Xhevat Llumnica dhe kapter Shpresa Gashi. Ndërkaq, rreshtermajori i FSK-së, Genc Metaj, mori pjesë në cilësinë e ligjëruesit, i cili më 30 gusht 2019 ka ligjëruar temën: „Udhëheqja dhe sfidat në udhëheqjen transformuese“. Ky është viti i katërt me radhë që FSK-ja merr pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare.

Pjesëtarët e Kompanisë së Taksë Forcës të FSK-së realizojnë me sukses marshimin „Gjeravica 2019“



Prishtinë, 20 SHTATOR - Pjesëtarët e Kompanisë së Taksë Forcës së Kërkim-Shpëtimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në bazë të Planit të trajnimeve dhe aktiviteteve për vitin 2019, kanë realizuar marshimin kondicional „Gjeravica 2019“ mbi 15 km të gjatë. Marshimi i njësisë së forcës operative u realizua në kushte jo të mira atmosferike, në një lartësi mbidetare prej 2656 metrash, nga „Bjeshkët e Junikut“ deri në majën e malit „Gjeravica“. Marshimi kishte për qëllimi përgatitjen fizike të pjesëtarëve të FSK-së në përballje me sfidat. Të gjithë pjesëtarët e kësaj kompanie arritën që me sukses të realizojnë këtë marshim mjaft sfidues.

Me nderime të larta varroset Rreshteri i parë Nijazi Uruqi



Gjilan, 20 SHTATOR - Sot nga familjarë, miq, shokë e ushtarak të Forcës së Sigurisë të Kosovës i është dhënë lamtumira e fundit nënoficerit të FSK-së Rreshter i parë Nijazi Uruqi. Para dite në kazermën „New Born“ në Gjilan janë bërë homazhe pranë arkivolit nga Komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale gjeneral brigade Naim Haziri, të gjitha njësitë e Forcës së Sigurisë të Kosovës, kolegë, shokë e bashkëluftëtarë. Më pastaj kortezhi ka vazhduar për në fshatin e lindjes-Bresalc, ku është varrosur me nderime ushtarake, në praninë e një numri të madh të qytetarëve nga e gjithë Kosova, miq e familjarë. Në fjalën e tij lamtumirëse, ish komandanti i Zonës Operative të Karadakut Ahmet Isufi çmoi lartë angazhimin e tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, duke theksuar se „Atëherë kur Atdheu thërriste për t`i dal zot, Nijaziu e la kurbetin dhe erdhi të luftojë me nderë për Atdheun“. Për herë të fundit nga i ndjeri është ndarë komandanti i Rexhimentit të Mbrojtjes Civile kolonel Shaip Haziri cili në fjalën e tij, theksoi: „Nuk ka ushtarak në Rexhimentin ku unë komandoj, që nuk e ka dashur dhe respektuar Nijaziun. Ka qenë shembull i një ushtaraku të zellshëm e me plotë motiv për punë. Me mençurinë dhe singeritetin e tij, Ai bëri për vetë këdo, që ka pasur rastin ta njoh. Ndihemi krenarë që bashkërisht ndërtuam themelet e sigurta të ushtrisë së Kosovës, për të cilën Nijaziu punoi pa reshtur gjithë jetën“. Në fund të ceremonisë u vendosën kurora të shumta lulesh nga shokët, miqtë, bashkëluftëtarët, kolegët, ushtarakët e shokët nga të gjitha viset shqiptare.

FORCA JONË

⋆⋆⋆ Viti VIII • Nr. 85 • 7 Nëntor 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ⋆⋆⋆

Presidenti Hashim Thaçi përgëzoi ekipin e FSK-së që fitoi medaljen e argjendtë në Britani të Madhe



Prishtinë, 29 TETOR - Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi priti sot komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Ramën dhe ekipin e FSK-së, i cili ditë më parë u nderua me medaljen e argjendtë në garën ndërkombëtare më prestigjioze në botë „Cambrian Patrol“ të mbajtur në Mbretërinë e Bashkuar. Presidenti Hashim Thaçi, njëherësh komandant Suprem i Ushtrisë së Kosovës, pasi përgëzoi gjeneral Ramën dhe ekipin e FSK-së për suksesin e arritur, tha: „Ushtarët tanë, kudo në botë po dëshmojnë aftësi, vigjilencë dhe profesionalizëm. Në çdo garë ndërkombëtare, ata po arrijnë suksese. Ky ekip i mrekullueshëm i ushtrisë sonë, sivjet sërish arriti të fitoi medalje në një prej garave më prestigjioze botërore, në „Cambrian Patrol“ të Britanisë së Madhe. Krenohem me ushtarët e Republikës së Kosovës“- u shpreh në fund të fjalës së tij presidenti i Kosovës z. Hashim Thaçi. Vlen të ceket se në këtë garë ushtarake morën pjesë 132 ekipe, prej të cilave 34 ekipe ishin nga shtetet e ndryshme të botës, ku ekipi i Forcës së Sigurisë të Kosovës fitoi medalje të argjendtë.

FSK-ja fitoi Medaljen e Argjendtë në garën ndërkombëtare „Cambrian Patrol 19“ në Britani



Prishtinë 18 TETOR - Në njërën prej garave ushtarake më prestigjioze në botë „Cambrian Patrol 19“, ekipi i Forcës së Sigurisë të Kosovës arriti që të rrëmbej Medaljen e Argjendtë. Gara patrulluese filloi më datën 16 tetor 2019 dhe zgjati 48 orë, pa ndërprerë, ku morën pjesë gjithsej 132 ekipe, prej të cilave 34 ishin nga shtetet e ndryshme. Kjo është hera e tretë që FSK-ja po merr pjesë në garën ndërkombëtare ushtarake „Cambrian Patrol“, e cila organizohet nga Brigada e Këmbësorisë 160-të e Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar. Përveç Republikës së Kosovës, në garën „Cambrian Patrol 19“ në Mbretërinë e Bashkuar, morën pjesë edhe ekipet e forcave të armatosura të vendeve të rajonit, si nga Maqedonia e Veriut, Bosnja e Hercegovina dhe Greqia. Gara „Cambrian Patrol 19“ është një aktivitet shumë sfidues dhe prestigjioz ushtarak që teston të gjitha aftësitë themelore ushtarake të ushtarit të sotëm, duke rritur aftësinë e udhëheqjes dhe nivelin e qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama në Konferencën e Shefave të Mbrojtjes në Gjermani



Gjermani 25 TETOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, mori pjesë në Konferencën e 27-të vjetore të shefave të Mbrojtjes, e cila u mbajt në Wiesbaden të Gjermanisë nga data 23-25 tetor 2019.Në këtë konferencë morën pjesë mbi 37 shefa të Mbrojtjes të shteteve evropiane, anëtare të NATO-s dhe shtete partnere të Kosovës. Konferenca e Shefave të Mbrojtjes u organizua nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe kishte për tematikë „Gatishmërinë Strategjike“, në kontekst të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së gatishmërisë kolektive bazuar në sfidat aktuale të sigurisë në botë. Po ashtu temë e kësaj konference ishte edhe ndërveprimi ndërmjet shteteve anëtare të NATO-s si dhe aftësia për t'u adaptuar ndaj sfidave të sigurisë. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë konferencës zhvilloi takime me shefin e Shtabit të Ushtrisë Amerikane gjeneralin James McConville dhe komandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Christopher Cavoli, si dhe me homologë të shumtë të shteteve mike. Komandanti i FSK-së, ndër të tjera në këtë konferencë ka thënë: „FSK-ja mbetet e përkushtuar në ndërtimin e aftësive të reja mbrojtëse sipas planit të tranzicionit, në mbështetje të plotë të partnerëve strategjikë, si dhe mbetet e përkushtuar në zhvillimin e kapaciteteve në të gjitha fushat me qëllim të ndërveprimit me partnerët strategjikë dhe me shtetet tjera partnere“.

Konkurs për studime në Akademinë e Forcave Ajrore dhe Akademinë Ushtarake WEST POINT të SHBA-ve

Prishtinë 22 TETOR - Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës shpall konkurs për pranimin e kadetëve të FSK-së, për studime, në Akademinë e Forcave Ajrore dhe Akademinë Ushtarake-WEST POINT të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Studimet mbahen në gjuhën angleze dhe zgjasin katër vjet. Është e dëshirueshme që kandidati të ketë të përfunduar testin TOEFL dhe testin SAT. Kandidatët do të nominohen nga Ministria e Mbrojtjes si kandidatë konkurrent për studime. Kadetët pas përfundimit të shkollimit do të emërohen oficer në FSK, në kohëzgjatje minimale të obligueshme, prej gjashtë (6) viteve. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa dallim kombi, race, dhe gjinie, të moshës 18-23 vjeç. Konkursi dhe formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes; mod.rks-gov.net Konkursi është i hapur prej datës 22 tetor 2019 deri më 04 nëntor 2019. Informata plotësuese: nr. tel. 038-603355

Marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë së Navigimit Ajror të Kosovës



Prishtinë 10 TETOR - Ministri i Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha, ka nënshkruar sot me Drejtorin e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, z. Bahri Nuredini, marrëveshjen për vendosjen e radarit në hapësirën e Aeroportit të Gjakovës. Kjo marrëveshje është nënshkruar bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 14/98, të datës 18 prill 2019, për dhënien në shfrytëzim në kohë të pacaktuar të Aeroportit të Gjakovës për nevojat strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Instalimi i këtij radari në Aeroportin e Gjakovës do të ngrisë edhe më tej sigurinë e fluturimeve civile dhe ushtarake në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës dhe është një hap me rëndësi të veçantë në normalizimin e plotë të hapësirës sonë ajrore, në bashkëpunim me NATO-n.

Zv. ministri Burim Ramadani priti komandantin e Forcave Tokësore të FA të Shqipërisë gjeneralin Albert Mullai



Prishtinë 22 TETOR - Zëvendësministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, z. Burim Ramadani, ka pritur sot në takim, komandantin e Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë(FARSH), gjeneral brigade Albert Mullai, me stafin e tij, i cili që nga dje është duke qëndruar për vizitë zyrtare në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Me këtë rast, zv. ministri Ramadani e ka falënderuar komandantin e Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralin Mullai, për ndihmën profesionale dhe bashkëpunimin e ndërsjellë. Ata gjithashtu biseduan edhe për thellimin e bashkëpunimit të mëtejmë në fushën e Sigurisë dhe fushën Ushtarake.Po ashtu, delegacioni i Forcave Tokësore të Republikës së Shqipërisë, gjatë qëndrimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës vizituan njësitë e FSK-së dhe Qendrën për Studime Universitare të FSK-së. Në takime të ndara, gjenerali Mullai u prit nga shefi i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Jeton Dreshaj dhe komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj, të cilët, gjeneralin Mullai e njoftuan me të arriturat e fundit në procesin e transformimit nëpër të cilin është duke kaluar FSK-ja, për sfidat e sigurisë, ndër të tjera diskutuan edhe për thellimin e bashkëpunimit dhe realizimin e projekteve të ndryshme që janë me interes të përbashkët të dyja forcave. Qëllimi i kësaj vizite ishte planifikimi dhe thellimi i programuar i stërvitjeve dypalëshe të trupave të FSK-së dhe FARSH-së, në veçanti të atyre speciale, me synim ngritjen e tyre profesionale, duke i përshtatur me kërkesat e NATO-s, në përputhje edhe me planin e transformimit të FSK-së.Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit bilateral të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe asaj të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gjenerali Rrahman Rama në ceremoninë e ndërrimit të komandës së shefit të Shtabit të Forcave të Përbashkëta në SHBA



Prishtinë 1 TETOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës(SHBA), dje për herë të parë mori pjesë në ceremoninë e ndërrimit të komandës së shefit të Shtabit të Forcave të Përbashkëta, që është mbajtur në bazën e përbashkët të ushtrisë amerikane \"Myer-Henderson Hall\" në Uashington. Gjatë kësaj ceremonie gjeneral Rama e uroi personalisht gjeneralin Milley, të cilit i dëshiroi suksese në mandatin e tij 4-vjeçar dhe i shprehu mirënjohje të thellë për mbështetjen e vazhdueshme të SHBA-ve në zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së. Pozita e shefit të Shtabit të Forcave të Përbashkëta konsiderohet pozita me e lartë në strukturën e ushtrisë amerikane, ku gjeneral Mark Milley do të jetë këshilltari më i lartë i Presidentit të SHBA-ve, Sekretarit të Mbrojtjes dhe i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, për çështje që ndërlidhen me sigurinë kombëtare të SHBA-ve. Gjenerali Mark A. Milley është emëruar shefi i 20-të i Shtabit të Forcave të Përbashkëta, duke e zëvendësuar gjeneralin Joseph Dunford, i cili për 4 vjet ka qëndruar në këtë pozicion mjaft të rëndësishëm.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë vizitës zyrtare në SHBA, nënshkruan:

Marrëveshje bashkëpunimi në mes FSK-së dhe Universitetit të Norwichit -SHBA



SHBA 21 TETOR - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më datë 17 tetor 2019, në kuadër të vizitës së tij zyrtare në SHBA, vizitoi Universitetin e Norwich-it në Vermont. Gjeneral Rama në emër të Ministrisë së Mbrojtjes ka nënshkruar Marrëveshje mirëkuptimi me Universitetin e Norwich-it për të bashkëpunuar në fushën e edukimit, hulumtimit shkencor në fushën ushtarake, si dhe garave në mes të kadetëve të këtyre institucioneve. Pas nënshkrimit të këtij memorandumi, Gjeneral Rama e falënderoi presidentin e këtij institucioni Richard Schneider për besimin dhe mundësinë e dhënë duke theksuar se ky bashkëpunim do të kontribuojë në avancimin e njohurive dhe përvojave të kadetëve të të dyja institucioneve. Gjeneral Rama së bashku me delegacionin e tij të përbërë nga kolonel Ilir Qeriqi, atashe i Mbrojtjes në SHBA, major Korab Dauti SHPFSK dhe major Jaser Mulla, asistent ushtarak i KOMFSK-së, patën rastin të vizitojnë Qendrën Trajnuese për Mbrojtje Kibernetike, ku nga stafi i kësaj qendre janë njoftuar për funksionimin dhe mbarëvajtjen e procesit të saj mësimor. Me një traditë 200-vjeçare, Universiteti i Norwichit-it, i cili njihet edhe si Kolegji Ushtarak i Vermontit, konsiderohet të jetë institucioni ushtarak më i vjetër në SHBA. Me një staf mjaft profesional dhe me një eksperiencë të jashtëzakonshme, qëllimi i këtij kolegji është që të edukojë dhe të trajnojë kadetët e rijnë për të qenë liderë të ushtrisë amerikane. Realizimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi pritet të filloj në vitin 2020.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Zëvendësministri Burim Ramadani priti ambasadorin e Turqisë Çagri Sakar



Prishtinë 24 TETOR - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani, ka pritur sot në Ministrinë e Mbrojtjes Ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë Çağrı Sakar, me të cilin u bisedua për zhvillimet e përgjithshme aktuale në Kosovë dhe mbi raportet mes dy shteteve partnere. Zëvendësministri Ramadani tha se në zhvillimin e përgjithshëm në Kosovë, sikurse edhe në rrugën tonë veri-atlantike, mbështetja e Turqisë është e rëndësishme. "Kosova është e përkushtuar në zhvillimin e gjithmbarshëm, avancimin e rrugës së saj drejt integrimeve në NATO-s dhe prosperitetin e të gjithë qytetarëve të saj pa dallime", tha zëvendësministri Ramadani. Nga ana e tij, Ambasadorin turk në Kosovë Çağrı Sakar vlerësoi bashkëpunimin me Kosovën në fusha të ndryshme, duke theksuar vazhdimin e mbështetjes për Kosovën nga ana e Republikës së Turqisë.

Komandanti i FSK-së, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Shoqata e Ushtrisë së SHBA-ve



Prishtinë 18 TETOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë zyrtare të Shoqatës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga data 14-16 tetor 2019, mori pjesë në njërin prej aktiviteteve më të mëdha ushtarake që organizohen nga kjo shoqatë. Në këtë aktivitet kanë marr pjesë më se 90 shtete të botës, duke përfshirë edhe Kosovën, ku përveç konferencave të ndryshme që ndërlidhen me aspektet e sigurisë u mbajt edhe panairi i industrisë ushtarake amerikane, i cili konsiderohet si njëri ndër panairet më të mëdha në botë. Gjeneral Rama në këtë panair vizitoi edhe disa kompani amerikane me pajisje dhe sisteme ushtarake. Gjithashtu, në kuadër të këtij aktiviteti, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, mori pjesë edhe në koktejin e organizuar nga shefi i Shtabit të Ushtrisë Amerikane, gjenerali James McConville. Me këtë rast, gjeneral Rama e ka falënderuar gjeneralin McConville si dhe ushtrinë amerikane për mbështetjen e vazhdueshme në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të FSK-së. Komandanti i FSK-së po ashtu ka mbajtur takime të rëndësishme edhe me përfaqësues të Departamentit të Mbrojtjes, para të cilëve pasqyroi të arriturat e FSK-së, si dhe shprehu dëshirën e tij për rritjen e bashkëpunimit dhe të mbështetjes nga Departamenti i Mbrojtjes. Në këto takime gjenerallejtënant Rrahman Rama i ka siguruar përfaqësuesit amerikanë të Mbrojtjes se plani i tranzicionit është duke u zhvilluar sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit me transparencë të plotë. Ky aktivitet i Shoqatës së Ushtrisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka për qëllim mbështetjen e ushtrisë amerikane, duke i bashkuar të gjithë përfaqësuesit e lartë të ushtrive të botës për të debatuar rreth çështjeve të ndryshme të kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë në botë.

Gjeneral Enver Cikaqi priti në takim lamtumirës gjeneralin e KFOR-it Reinhard Ruckenstuhl



Prishtinë, 03 TETOR - Zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjeneral majori Enver Cikaqi, sot priti në takim lamtumirës zëvendëskomandantin e KFOR-it, gjeneral brigade Reinhard Ruckenstuhl. Në takim mori pjesë edhe shefi i Stafit në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, gjeneral brigade Jeton Dreshaj. Me këtë rast, zv. komandanti i FSK-së gjeneral Cikaqi e falënderoi zv. komandantin e KFOR-it gjeneralin Ruckenstuhl për bashkëpunimin e deritanishëm me FSK-në, me qëllim të avancimit dhe të ngritjes së kapaciteteve të FSK-së në të gjitha fushat, ndërsa pasardhësit të tij gjeneral brigade Laurent Michaudit i uroj detyrën e re. Ndërkaq zv. komandanti i KFOR-it, gjenerali Ruckenstuhl, shprehet i kënaqur për bashkëpunimin e KFOR-it me FSK-në gjatë periudhës së shërbimit të tij në Kosovë. Ai po ashtu tha se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe me pasardhësin e tij, gjeneralin Laurent Michaud . Në fund, si shenjë mirënjohjeje për bashkëpunimin e deritanishëm, të dy gjeneralët shkëmbyen dhuratа me njëri-tjetrin.

Gjenerali Gëzim Hazrolli ligjëroi në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Republikën e Shqipërisë



Tiranë, 15 TETOR - Drejtori i Drejtorisë për Inteligjencë dhe Siguri në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneralmajori i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) Gëzim Hazrolli me ftesë të Akademisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është ftuar të ligjëroi në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM). Gjeneral Hazrolli në një takim zyrtar u prit nga komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Bajram Begaj. Gjatë takimit të dy gjeneralët biseduan për bashkëpunimin e vazhdueshëm të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Gjeneral Hazrolli në ambientet e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes ligjëroi para një audience të gjerë ushtarake dhe civile të strukturave të larta të Forcave të Armatosura dhe përfaqësueseve të institucioneve të sigurisë të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe përfaqësues nga vendet e rajonit dhe të NATO-s, lidhur me temën „Mjedisi kombëtar i sigurisë dhe bashkëpunimi mes agjencive". Më pas, gjeneral Gëzim Hazrolli takoi edhe oficerët e lartë të FSK-së të cilët gjenden për trajnime/kurse të karrierës në Republikën e Shqipërisë.

Intervistë me pilotin e FSK-së, nëntogerin Krenar Voca

Vetëm me përkushtim dhe vendosmëri mund të arrihet çdo sukses

Gazeta „Forca Jonë“: Çka do të thotë për Ju, të jeni pilot i Ushtrisë së Kosovës-FSK-së?

Nëntogeri Krenar Voca: Të jesh pilot i ushtrisë së Kosovës për mua do të thotë përgjegjësi dhe privilegj, si dhe përmbushja e të gjitha detyrave që na takojnë si pilotet e parë të Ushtrisë së Kosovës. Njëherë është nder dhe kënaqësi e veçantë për ne, dhe si njësi e re në Ushtrinë e Kosovës. Unë shoh çdo përmbushje të detyrës dhe çdo aktivitet dhe organizim shtesë si shembull për ata që vijnë pas nesh, prandaj shërbimi ndaj atdheut dhe aftësia për të parë detyrën time me larg sesa thjesht profesion është prioritet për mua.

Gazeta „Forca Jonë“: Cili ishte itinerari i studimeve, sukseset dhe vështirësitë që keni hasur gjatë studimeve ?

Nëntogeri Krenar Voca: Edhe vështirësitë mirëpo edhe sukseset fatmirësisht ishin pjesë e pandashme e rrugëtimit për tu bërë pilot. Hapi i parë për ne ishte diplomimi në Akademinë Ushtarake që zgjati plot 4 vite, më pas, në gjuhen turke, kam ndjekur kursin për pilot, nder sfidat kyçe të së cilës ishte largimi nga atdheu dhe familja, duke shtuar këtu edhe vështirësitë në studimet e pilotimit, ndërsa suksesi më i madh për mua ishte arritja e qëllimeve të mija, për tu kthyer dhe për t'i shërbyer vendit tim me përkushtimin më të lartë moral.

Gazeta „Forca Jonë“: Në qendrën ushtarake - (vendi-shkolla, a ka pasur studentë të shteteve tjera dhe cili ishte dallimi profesional) në cilat fusha tjera jeni përgatitur ?!



Nëntogeri Krenar Voca: Në akademinë ushtarake ka pasur të pranishëm student nga vende të ndryshme, kurse në trajnimin për pilot ishin të pranishëm vetëm kadetë nga Kosova dhe Turqia. Përgatitja profesionale ishte përgjithësisht e njëjtë për të gjithë. Gjatë akademisë jemi përgatitur në fusha të ndryshme si përdorimi i armëve, disiplinën ushtarake e shumë të tjera, ndërsa gjatë trajnimit për pilot detyrë kryesore ishte përgatitja në fluturim gjatë situatave të ndryshme si ato në gjendje stresi, raste emergjence e të tjera.

Gazeta „Forca Jonë“: Në akademinë Ushtarake – cili ka qenë trajtimi i të qenit kadetë shqiptarë?

Nëntogeri Krenar Voca: Trajtimi për kadetët shqiptarë gjatë akademisë ka qenë tërësisht i njëjtë si për kadetët e tjerë, asnjë dallim nuk është bërë mes përgatitjes tonë ushtarake dhe përgatitjes së kadetëve nga vendet e tjera qoftë atyre të Turqisë qoftë nga shtetet tjera.

Gazeta „Forca Jonë“: Cila është përvoja praktike në lëmine e pilotimit ?

Nëntogeri Krenar Voca: Praktika në lëmine e fluturimit ka përfshire gjithsej 6 fusha me 140 orë fluturim, ato bazike me AB-206 gjithsej 30 orë fluturim. Pastaj ato bazike me UH-1 po ashtu 30 orë, fluturimet në raste emergjence me UH-1 20 orë, fluturimet përmes radio sinjaleve 30 orë në simulacion, fluturim taktik me UH-1 15 orë, dhe fluturim me UH-1 natën 15 orë. Mirëpo për shkak të dy aksidenteve me helikopterin e tipit UH-1, fluturimet me këtë helikopter u anuluan prandaj nuk kemi arritur t'i kompletojmë orët e planifikuara me UH-1, prandaj kemi vazhduar fluturimet vetëm me helikopterin e tipit AB-206, me gjithsej 60 orë fluturim të kompletuara.

Gazeta „Forca Jonë“: Cila është ndjenja gjatë fluturimit në qiell të hapur?

Nëntogeri Krenar Voca: Kjo pyetje është gati e pamundur për t'iu përgjigjur. Kënaqësia e fluturimit nuk mund të përshkruhet me fjalë. Për mua pjesa më e bukur janë pamjet që shohim nga lart, dhe nëse pranon të gjitha përgjegjësitë që vijnë me të, fluturimi të jep një ndjenjë të lirisë.

Gazeta „Forca Jonë“: Cili do të ishte mesazhi drejtuar rinisë të cilit dëshirojnë të bëhen pilotë?

Nëntogeri Krenar Voca: Mesazhi im për të gjithë që kanë synim të bëhen pilot është të pranojnë përgjegjësitë që vijnë me të dhe të vendosin dëshirën dhe qëllimin e tyre para të gjithave në mënyrë që vullneti të mposhtë vështirësitë që mund të hasin gjatë këtij rrugëtimi. Vetëm me përkushtim dhe vendosmëri mund të arrihet çdo sukses.





Akreditohet Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë të Kosovës



Prishtinë, 17 TETOR - Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK) ka nxjerrë vendim me rastin e procesit të validimit dhe akreditimit të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë të Kosovës. KD i AKK- së, në vendimin e lëshuar, njofton se „Validohet dhe akreditohet Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë së Kosovës (QSU), me adresë: Kazerma „Adem Jashari“ në Prishtinë, për periudhën tri vjeçare 30.09.2019 deri 30.09.2022 me kualifikimin: „Nëntoger në Forcat e Armatosura, Niveli V sipas KKK me 120 kredi të AAP“. Forca e Sigurisë e Kosovës në kuadër të mandatit të ri për ngritjen e kapaciteteve profesionale të edukimit ushtarak ka rishikuar dhe zhvilluar plan-programin e QSU-së, për fillimin e procesit të akreditimit bazuar në nenin 23, pika 6 e Ligjit nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, andaj si rezultat i një pune profesionale të KDS-së dhe QSU-së, është marr vendim mbi akreditimin e profesionit të ushtarakut nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (KD i AKK). Kjo nënkupton që kadetët që studiojnë në QSU, tashmë diplomohen në dy programe të akredituara njëkohësisht, programi profesional „Nëntoger në Forcat e Armatosura“ i akreditar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) dhe ai civil me titullin „Baçelor i Shkencave“ i akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Këto dy diploma janë kriter bazë për emërimin si nëntoger në FSK apo Forcat e Armatosura të vendeve tjera. Akreditimi i QSU-së si institucion edukativo-arsimor ushtarak dhe validimi i programit të saj, është një hap i rëndësishëm për të ardhmen e FSK-së. Ky proces do të ndikojë në masë të madhe që kadetët të aftësohen në mënyrë më të strukturuar dhe më cilësore. Ndërsa, në anën tjetër kjo kërkon nga stafi akademik që të jenë në hap me zhvillimet ushtarake dhe të përdorin teknikat më moderne të mësimdhënies.

Vizioni i FSK-se është që në të ardhmen të avancojë edhe më tej QSU-në dhe të zhvillohet si institucion ushtarak rajonal, me vlera standarde dhe parime bashkëkohore për përgatitjen e gjeneratave të reja në ballafaqim me sfidat e së ardhmes.





Në Qendrën e kërkim-Shpëtimit të FSK-së

Trajnim i përbashkët i njësive të kërkim-shpëtimit të FSK-së dhe FARSH-së



Prishtinë 24 TETOR - Në ambientet e Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në Regjimentin e Mbrojtjes Civile në Pomozotin, që nga data 4 Tetor e deri më 1 Nëntor 2019, është duke u realizuar „Kursi i Avancuar i Kërkim-Shpëtimit në Male“, në të cilin po marrin pjesë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Përveç pjesës teorike e cila është duke u realizuar në ambientet e kazermës „Evropianët e Rinj“ në Pomozotin, pjesën praktike, kursantët janë duke e realizuar në terrene të ndryshme malore tepër sfiduese, si te: Guri i Plakës, në Bjeshkët e Rugovës-Pejë, në Bjeshkët e Pashtrikut në Gjakovë dhe në malet e Sharrit në Prizren. Ky trajnim mjaft sfidues është duke u realizuar nga instruktorët e Qendrës për Trajnime të Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, të cilin po e ndjekin 6 pjesëtarë të FSK-së dhe 10-të pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i këtij trajnimi është ngritja e njohurive të mjaftueshme për përballje me situata të ndryshme, që ndërlidhen me operacione malore dhe po ashtu në aftësimin për menaxhimin e situatave të ndryshme gjatë ballafaqimit me emergjenca të ndryshme natyrore.




Përfundoi ushtrimi në vendkomandë „Shpata e Argjendtë 2019-02“



Prishtinë, 01 TETOR - Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit me KFOR-in, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) nga data 24 deri më 26 shtator 2019 ishte pjesë e ushtrimit në vendkomandë „Silver Sabre 2019-02“. Këtë ushtrim KFOR-i e ka realizuar përreth 56 orë pandërprerë në dy vendbazime: në kampin e KFOR-it në Film City dhe në qendrën 112 të AME në Hajvali. Pjesë e realizimit të këtij ushtrimi ishin disa partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë: Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës (PK), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Këshilli i Sigurisë Kombëtare (KSK), NALT-i, KFOR-i dhe EULEX-i.Në DIV-Day-in e këtij ushtrimi të pranishëm ishin edhe gjeneralët e FSK-së; komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) gjeneral brigade Irfete Spahiu dhe komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH) gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj. Të gjithë të pranishmit, në ditën përfundimtare të ushtrimit, nga përgjegjësit e ushtrimit përmes takimeve të shkurtra informues (brifingjeve) u njohën me mbarëvajtjen e ushtrimit. FSK-ja në këtë ushtrim të përbashkët mori pjesë me mbi 20 pjesëtarë, që nga faza fillestare e deri në ditën e ekzekutimit të këtij ushtrimi, me qëllim të demonstrimit të aftësive të veprimit në një mjedis shumëkombësh dhe të shkëmbimit të përvojave me institucionet tjera. Roli i pjesëtarëve të FSK-së në ushtrimin „Silver Sabre 2019-02“, ishte zhvillimi i operacioneve të simuluara të kërkim-shpëtimit në ujëra, deminim, MKAB dhe xhenio.

Oficerë të Kursit të Lartë të Shqipërisë vizitojnë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në



Prishtinë, 03 TETOR - Në Ministrinë e Mbrojtjes sot u prit një delegacion i pjesëmarrësve vijues të kursit dhe stafi akademik i Kursit të Lartë për Mbrojtje dhe Siguri i Akademisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i kryesuar nga zv. komandanti i Akademisë njëherësh edhe përgjegjës i kursit, koloneli Edmond Vraneshi. Delegacioni nga Shqipëria u prit nga drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrime Euro-Atlantike, kolonel Agron Bajrami, i cili në emër të drejtuesve të Ministrisë së Mbrojtjes përshëndeti mysafirët dhe vlerësoi lart vizitën e kursantëve nga Shqipëria, Greqia, Britania e Madhe, Gjeorgjia, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Italia. Më pas, kolonel Haki Hoti, drejtor i Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim, bëri një prezantim lidhur me historikun e ngritjes, zhvillimit dhe tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke filluar nga Rishikimi i Strategjisë së Sektorit të Sigurisë së Kosovës, miratimi i ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në dhe tani për Procesin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të Forcës. Gjithashtu, oficerët pjesëmarrës të kursit me anë të pyetjeve shprehën interesimin e tyre për tematikën e prezantuar lidhur me ngritjen dhe zhvillimin e Forcës, procesin e tranzicionit dhe planet për zhvillimin e saj në të ardhmen. Oficerët e lartë, pjesë e delegacionit të KLMS-së, vizituan edhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë si dhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në kazermën „Skënderbeu“ në Ferizaj, ku u njoftuan nga afër me misionin, detyrat dhe aktivitetet e tyre. Qëllimi mësimor i vizitës së KLMS-së ishte njohja me institucionet e sigurisë shtetërore dhe ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, dhe se si është institucionalizuar koncepti i sigurisë bashkëpunuese në rastin e Kosovës.

Gjeneral brigade Irfete Spahiu priti atasheun e Mbrojtjes të Kroacisë, kolonelin Marijana Pleša Čadonić



Prishtinë, 29 TETOR - Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, gjeneral brigade Irfete Spahiu, priti sot në vizitë zyrtare atasheun jo rezident të Mbrojtjes së Kroacisë në Kosovë, kolonel Marijana Pleša Čadonić. Komandanti i KDS-së, gjeneral Spahiu, me këtë rast, e njoftoi kolonelin Čadonić lidhur me procesin e zhvillimeve dhe të arriturat e përgjithshme të KDS-së. Gjeneral Spahiu e falënderoi atasheun kroat për bashkëpunimin dhe për mbështetjen e madhe në vazhdimësi të ushtrisë kroate për FSK/KDS-në. Gjithashtu, gjatë takimit u bisedua për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen edhe në fushën e trajnimit.

Në Qendrën e Stërvitore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Pjesëtarët e FSK-së pjesë e trajnimit për eliminimin e mjeteve eksplozive të pashpërthyera



Prishtinë 14 TETOR - Në Qendrën Stërvitore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) përfundoi Kursi për eliminimin e mjeteve eksplozive të pashpërthyera
(Explosive Ordance Disposal) niveli i II-të, ku përveç pjesëtarëve të FARSH-it morën pjesë edhe 5 pjesëtarë të Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, dy prej të cilëve ishin në cilësinë e instruktorëve, ndërsa tre të tjerë kursantë.

Në këtë ceremoni të pranishëm ishin; shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku, atasheu ushtarak i Kosovës, kolonel Bashkim Shillova, atasheu ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës i akredituar në Shqipëri, kapiten i rangut II James Hilton, drejtorë të drejtorive në SHP, si dhe komandantë të strukturave vartëse. Kursi u realizua në periudhën kohore prej 16 shtatorit deri më 11 tetor 2019. Në ceremoninë përmbyllëse të kursit, para të gjithë mysafirëve kursantët demonstruan asgjësimin e një pakoje të improvizuar me mjete eksplozive (Improvised Explosive Device), si dhe heqjen nga një djegore të një predhe 152 milimetrash. Instruktori i FSK-së, tetari Roland Reshitaj, shprehet se ndihet mjaft i privilegjuar që është instruktor i kursantëve që janë pjesë e NATO-s. „Për mua është privilegj dhe përgjegjësi të jem i angazhuar si instruktor i kursantëve në një trajnim të këtij niveli profesional me pjesëtarë të NATO-s, të cilët bartin shumë eksperienca në misione të shumta si jashtë shtetit ashtu edhe në detyra të tjera brenda vendit. Edhe ne u munduam që të japim sa më shumë nga eksperiencat tona, që rreziku në detyra reale të reduktohet maksimalisht”. Në përfundim të ceremonisë, për të gjithë kursantët që ishin pjesë e këtij kursi, u ndanë certifikata.

FSK-ja trajnohet nga trajnerët e ushtrisë britanike



Prishtinë, 03 TETOR - Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, sot u mbajt ceremonia e certifikimit të 28 kursantëve në „Kursi i Lidershipit për Udhëheqësit e Rinj“, i cili u realizua në periudhën kohore 09.09 - 03.10.2019, nga instruktorë të BMATT-it të ushtrisë së Britanisë. Në ceremoni ishte i pranishëm edhe zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjeneral majori Enver Cikaqi, i cili vlerësoi lart zhvillimin e lidershipit te kursantët. „ Zhvillimi i lidershipit te kursantët, veçanërisht te lidershipi i bazuar në vlera, është një metodë e udhëheqjes e cila përdor një përzierje të stileve të ndryshme të lidershipit për të arritur efektin më të mirë“. Udhëheqësi i ekipit të BMATT-it, kapiteni Anthony Kinsella, shprehet se ai dhe ekipi i tij ndihen të nderuar që punojnë me pjesëtarë të FSK-së: „Ne jemi krenarë që jemi pjesë e kontributit të vazhdueshëm të Mbretërisë së Bashkuar në institucionet e sigurisë të Kosovës dhe në mënyrë të veçantë në zhvillimin e FSK-së, derisa po kalon në mandatin e ri. Jam i entuziazmuar kur shoh zhvillimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve të BMATT-it me FSK-në dhe mirëpres mundësinë e ardhshme për bashkëpunim të vazhdueshëm dypalësh në mjedisin e trajnimit“. Po ashtu, gjatë fjalës së tij, zv. komandanti i KDS-së, koloneli Mehmet Lladrovci, tha se ky trajnim është edhe një tregues i fortë për këtë zhvillim profesional, i cili vjen si rrjedhojë e një bashkëpunimi shumë të lartë me partnerët tanë ndërkombëtarë. Kursi ishte njëmujor dhe mjaft sfidues si nga pikëpamja psikike ashtu edhe fizike. I gjithi ishte i fokusuar në lidership, komandim dhe mjedis taktik. „Kursi i Lidershipit për Udhëheqësit e Rinj“, përfundoi me zhvillimin treditor të ushtrimit „Bohemian Resolve“, në të cilin përfshihen ushtrime reale për t'i sfiduar kursantët në kryerjen e operacioneve sfiduese fizike në nivel togu. Qëllimi i këtij kursi është që nënoficerët dhe oficerët e rinj, të mësojnë taktikat e këmbësorisë si një mjet për të zhvilluar udhëheqjen dhe komandimin.



Forca e Sigurisë e Kosovës mban trajnim për Policinë e Kosovës

Prishtinë 15 TETOR - Kompania për Operacione me Civil (KOC) e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjatë javës së kaluar, ka mbajtur trajnimin „Angazhimi me Lider Kyç“ për Policinë e Kosovës të Drejtorisë Rajonale të Gjilanit. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin oficerë policorë të stacioneve policore të Gjilanit, Novobërdës, Kamenicës, Ranillukut, Vitisë, Parteshit dhe Kllokotit. Ky trajnim është organizuar në vazhdën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së FSK-së për institucionet e Republikës së Kosovës. Bazuar në nevojat e institucioneve të Kosovës, FSK-ja mbështet të gjitha institucionet në ngritjen e kapaciteteve të tyre operacionale. FSK-ja është e gatshme dhe ka për synim mbështetjen e të gjitha institucioneve me fokus gjithë përfshirjen etnike dhe gjinore. Ky trajnim është planifikuar, organizuar dhe ekzekutuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, përkatësisht nga KOC dhe EMCU (Elementi Mbështetës Civil Ushtarak).



FSK-ja trajnon zjarrfikësit e Kosovës për „Mbijetesë dhe shpëtim në ujëra“

Prishtinë, 09 TETOR - Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QTKSH) të FSK-së, në kazermën „Evropianët e Rinj“ në Pomozotin, zjarrfikësit nga Kamenica, Peja, Gjilani, Klina, Gjakova, Drenasi, Mitrovica dhe Suhareka përfunduan kursin për „Mbijetesë dhe shpëtim në ujëra“. Trajnimi u realizua nga Instruktorët e Qendrës Trajnuese të Kërkim-Shpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe është zhvilluar në një periudhë 4 ditore në lokacione të ndryshme: Pomozotin, në pishinë në Banjë dhe në liqenin e Batllavës. Zjarrfikësit teorikisht dhe në mënyrë praktike përvetësuan aftësi në shpëtimin dhe trajtimin e viktimave të aksidentuara nga uji, përfshirë këtu teknikat e notit efektiv, ndërtimin e mjeteve të improvizuara të lundrimit dhe teknikat e shpëtimit të viktimave nga vështirësitë në ujë.



Veprimet si reagues të parë si dhe trajtimi mjekësor kanë përbërë një pjesë të madhe të trajnimit duke bërë kështu që zjarrfikësit të kalojnë nëpër skenarë të ndryshme për të ushtruar dhe praktikuar ato aftësi. Prezent në ceremoninë e certifikimit ishin Shefki Abdullahu dhe Agim Haziri nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, nënkolonel Shpend Zogaj dhe shef i Stafit të Gardës Kombëtare të cilët përgëzuan dhe uruan zjarrfikësit dhe instruktorët e QTKSH-së për motivimin dhe punën e palodhshëm të treguar gjatë trajnimit si dhe dedikimin ndaj punës së përbashkët për të shpëtuar jetë.

FSK-ja fitoi Medaljen e Argjendtë në Britani të Madhe





Forca e Sigurisë së Kosovës mori pjesë në Garën Ushtarake, prestigjioze „Cambrian Patrol - 19“ e cila u organizua nga Brigada e Këmbësorisë 160-të e Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar, nga data: 16-19 tetor 2019



Ushtarët tanë në çdo garë ndërkombëtare po dëshmojnë aftësi, përkushtim dhe profesionalizëm të lartë. Ekipi ushtrisë sonë, në këtë garë ndërkombëtare fitoi Medaljen e Argjendtë.





FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 86 • 6 Dhjetor 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Pas reagimit të shpejtë të njësisë së kërkim-shpëtimit urban të Gardës Kombëtare të FSK-së në Shqipëri

Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta dekoroi me „Dekoratën e Artë të Shqiponjës“ njësitet e FSK-së

Prishtinë, 4 DHJETOR - Intervenimi i shpejtë në shpëtimin e jetëve të qytetarëve të prekur nga tërmeti i 26 nëntorit në Thumanë dhe Durrës, i Njësitit të Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, u vlerësua lart nga banorët e prekur nga tërmeti, qytetarët e Shqipërisë dhe nga institucionet e Republikës së Shqipërisë.



Njësitet e shpëtimit të FSK-së, mirënjohjen më të lartë, për reagimin e shpejtë për t'iu ardhur në ndihmë qytetarëve të prekur nga tërmeti i 26 nëntorit, në Durrës dhe Thumanë e mori nga presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta, i cili për forcën në detyrë (task forcën) të FSK-së ndau "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" dhe "Dekoratën për Merita të Veçanta" për njësitin K-9 të FSK-së. Ai u shpreh se Kosova duhet të jetë krenare për Forcën e Sigurisë, për të shtuar se çdo vend i NATO-s, do të ishte i kënaqur me atë që ka shfaqur FSK-ja gjatë ditëve të kërkim-shpëtimit në Shqipëri, pas tërmetit të fuqishëm që goditi vendin. Presidenti Meta, shprehu konsideratë edhe për qenin hero të FSK-së, i cili shpëtoi jetë pas tërmetit.

Forca e Sigurisë së Kosovës, konkretisht Njësia e Kërkim Shpëtimit e Gardës Kombëtare të FSK-së, dy ekipet e Policisë Ushtarake, një ekip i Njësisë së Komunikimit dhe dy pjesëtarë të Njësisë për Operacione Civile, nga data 26.11.2019 deri me date 29.11.2019 kanë zhvilluar operacionet e kërkim shpëtimit në Shqipëri. Kontingjenti i FSK-se ka qenë i ndarë në dy grupe. Njeri grup ka zhvilluar operacione në Thumanë, ndërsa grupi tjetër ka zhvilluar operacione në Durrës.

Kontingjenti i FSK-së ka qenë elementi i parë ndërkombëtarë i cili është dislokuar në vend incidente dhe ka asistuar autoritetet lokale për kërkimin e personave të cilët kane mbetur nen rrënoja pas tërmetit të orëve të hershme të mëngjesit.

Përveç këtyre ekipeve specialistike të K/SH, pjesë e kontingjentit kanë qenë edhe dy pjesëtarë të Njësisë për Operacione Civile, të cilët kanë koordinuar të gjithë përpjekjen institucionale të FSK-së për t' i asistuar autoritetet në Shqipëri si dhe kanë realizuar aktivitete në administrimin e përgjithshëm të situatës në Durrës dhe Thumanë. Pastaj si ekipe të atashuara të kontingjentit kanë qenë ekipet e Policisë Ushtarake, Njësia e Komunikimit dhe ekipet mjekësore për t'i asistuar forcës në detyrë.

Gjithashtu edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama kanë shprehur mirënjohje për intervenimin e shpejtë të Njësisë së Kërkim-Shpëtimit dhe Njësisë së K-9, që, si një trup i vetëm, me sakrificë, vetëmohim, disiplinë dhe profesionalizëm kanë kryer punën e vet, duke



shpëtuar edhe jetë njerëzish nga rrënojat e shtëpive të rrënuara nga tërmeti.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, në veçanti ka vlerësuar dhe përgëzuar çdo ushtar dhe oficer veç e veç, që kanë qenë pjesëmarrës në misionin, për të shtuar se: „Njësitet e FSK-së, na kanë bërë, që të ndihemi krenarë".

Gatishmëria dhe operacionaliteti i pjesëtarëve të FSK-së kanë qenë të rëndësishme përmes operimit me specialitete të ndryshme gjatë gjithë kohës. Në kuadër të ekipeve të kërkim- shpëtimit ishte edhe ekipi e K9 (me qen nuhatës për lokalizimin e të gujuarve), specialistë të vëzhgimit me kamera.

FSK-ja shënoi Ditën e saj me ceremoni ushtarake



Prishtinë, 27 NËNTOR - Në kazermën „Adem Jashari"në Prishtinë, me ceremoni ushtarake u shënua 27 Nëntori-Dita e Forcës. Njësitet e FSK-së, parakaluan me emblema, flamuj dhe grada të reja.

Ceremonia për shënimin e një-vjetorit të themelimit të ushtrisë së Kosovës, filloi me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të FSK-së, nga presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Vijon në faqen e katërt

Gjenerali amerikan Mark Millei uron gjeneralin Rrahman Rama për Ditën e Forcës




Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, me rastin e Ditës së Forcës, ka marrë letër urimi nga kryetari i Shefave të Stafeve të Përbashkëta të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjenerali i Ushtrisë së SHBA-ve, Mark Millei, (Mark A. Milley - CHAIRMAN OF THE JOINT CHIEFS OF STAFF). Në urim thuhet: „Urime për Ju, burrat dhe gratë të Forcës së Sigurisë të Kosovës, me rastin e festës së Ditës së Forcës të Sigurisë së Kosovës. Në këtë përvjetor të rëndësishëm, unë vlerësoj lart përkushtimin tuaj në kryerjen operacioneve në përgjigje ndaj krizave dhe operacioneve për mbrojtje civile në Kosovë.Puna juaj për të krijuar një Forcë të integruar është demonstruar në iniciativat dhe reformat sociale të lidershipit të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Ushtria e SHBA-ve vlerëson përkushtimin e lidershipit tuaj dhe partneritetin tonë me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Urimet më të mira për këtë rast të veçantë." Përfundon urimin e tij, kryetari i Shefave të Stafeve të Përbashkëta të Ushtrisë së SHBA-ve, gjenerali Mark Milley.

Ministri i Mbrojtjes dhe Komandanti i FSK-së vizituan zonat e goditura nga tërmeti në Shqipëri

Berisha: „Na nderon mirënjohja e qytetarëve të Durrësit dhe Thumanës për FSK-në“



30 NËNTOR - Ministri Berisha ka takuar edhe ushtarakët e FSK-së, të cilët që nga momentet e para pas tërmetit tragjik që goditi Shqipërinë, me shumë profesionalizëm e përkushtim morën pjesë në operacionet e kërkim-shpëtimit. „Sot vizituam zonat më të goditura nga tërmeti në Shqipëri. Është e papërshkrueshme dashuria dhe mirënjohja e thellë e qytetarëve të Durrësit dhe Thumanës për trupat e FSK-së që morën pjesë në operacionet e kërkim-shpëtimit gjatë këtyre ditëve. Banorët treguan për shumë raste trimërie kur ushtarët e Kosovës me vetëdije kanë rrezikuar jetën e tyre duke hyrë në objekte të rrënuara, apo në rrënim, për të shpëtuar jetë të tjera” ka thënë ministri Berisha, pasi takoi ushtarakët e FSK-së. “Në këto ditë të dhimbjes së madhe për shqiptarët, shqiptarët u bashkuan më shumë se kurrë” ka shtuar Berisha.

Gjeneral Rama: „Ushtarët tanë me profesionalizëm dhe përkushtim bënë më të mirën që t'u vijnë në ndihmë vëllezërve tanë“



Durrës 27 NËNTOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës Gjenerallejtënant Rrahman Rama ka shoqëruar kryetarin e Kosovës z. Hashim Thaçi, në vizitë zonave të goditura nga tërmeti i djeshëm në Durrës dhe Thumanë të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte që të njihen nga afër me punën dhe angazhimet e njësiteve të FSK-së si dhe për të inkurajuar ushtarët në misionin humanitar që po bëjnë në ndihmë të banorëve të goditur nga kjo fatkeqësi natyrore. Kjo vizitë ka për qëllim edhe shprehjen e solidaritetit të madh dhe bashkë dhimbjen me qytetarët që kanë humbur më të dashurit e tyre dhe të gjithë ata që kanë pësuar dëme nga ky tërmet. Komandanti i FSK-së Gjenerallejtënant Rrahman Rama, pasi takoi ushtarët e FSK-së dhe u njoftua me angazhimin e tyre deklaroi: „Ushtarët tanë janë duke u munduar të bëjnë më të mirën, atë që është e mundur dhe për këtë keni dëgjuar edhe vlerësimet e institucioneve vendore si dhe të qytetarëve që i kanë bërë për njësitë tona këtu. Për profesionalizimin e treguar, përkushtimin, angazhimin dhe sakrificën që po bëjnë këto ditë në ndihmë vëllezërve tanë, unë i përgëzoj të gjithë ushtarët pjesë e këtij operacioni“ ka shtuar gjenerallejtënant Rama. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjithashtu ka shprehur gatishmërinë e dërgimit të trupa shtesë në operacionet e kërkim-shpëtimit në rast nevoje. Ushtarët e FSK-së për punën dhe angazhimin e tyre profesional i ka takuar dhe përgëzuar edhe Presidenti Thaçi. Njësitë e specializuara të Gardës Kombëtarë të FSK-së, që nga paradita e djeshme ju kanë bashkuar operacioneve të kërkim-shpëtimit pas tërmetit shkatërrues që goditi Shqipërinë.

Në Ministri të Mbrojtjes u mbajt Konferenca e Dytë „FSK dhe Partnerët 2019“



Prishtinë, 26 NËNTOR - Në Ministri të Mbrojtjes u zhvilluan punimet e sesionit vjeshtor të Konferencës „FSK dhe Partnerët 2019“. Në konferencë morën pjesë atashe të mbrojtjes nga vendet partnere si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Shqipëria, Kroacia, Italia, Turqia, Franca, Holanda, Belgjika, Çekia, Hungaria, Maqedonia, Mali i Zi dhe për herë të parë edhe Jordania.

Në Konferencë morën pjesë: Ministri Rrustem Berisha, zv. ministri Kadri Kastrati, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë, Faruk Geci, drejtori i Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s gjeneral brigade Michael Oberneyer, si dhe oficerë dhe zyrtarë të tjerë të lartë të FSK-së, KFOR-it dhe NALT-it.

Konferencën e shpalli të hapur ministri Berisha, i cili në fjalën përshëndetëse theksoi rëndësinë e veçantë të Konferencës duke pasur parasysh periudhën intensive të aktiviteteve përmbyllëse të vitit të parë të tranzicionit. Duke e vlerësuar si vit të suksesshëm, ministri Berisha theksoi se :”Një ndër objektivat e kësaj Konference është mbajtja dhe avancimi i partneritetit dhe dialogut mes FSK dhe partnerëve, në udhëtimin tonë të përbashkët gjatë fazës së tranzicionit”. Ai më pas njoftoi të pranishmit me të arriturat kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, me të arriturat konkrete gjatë periudhës përkatëse duke theksuar se këto të arritura i atribuohen mbështetjes së madhe të partnerëve tanë dhe bashkëpunimit të thellë dypalësh me ta. „FSK-ja edhe me kapacitetet e tanishme është e gatshme t’i përkrahë partnerët dhe aleatët tanë të NATO-s, në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe demokracisë, gjithkund në botë, sa herë që partnerët dhe aleatët tanë kanë nevojë për përkrahjen tonë. Të gjitha të arriturat e FSK-së janë suksese të përbashkëta dhe kjo histori suksesi është e Kosovës dhe e partnerëve tanë“, - tha në fund ministri Berisha duke falënderuar shtetet partnere në krye me SHBA-të, NATO-n për mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin në zhvillimin e FSK-së. Drejtori i NALT-it gjeneral brigade Michael Oberneyer në fjalën e tij përshëndetëse shprehu kënaqësinë që udhëheq Ekipin Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s, në shërbim të zhvillimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, duke vlerësuar periudhën e organizimit të Konferencës si mundësi e mirë për të bashkërenduar aktivitetet e planit vjetor 2020 të NALT-it me planin vjetor 2020 të FSK-së. Gjithashtu në një prezantim të veçantë u paraqit edhe Strategjia e NALT-it 2020-2022 ku përfshihen objektivat, detyrat, sfidat, struktura, niveli i angazhimit si dhe qasja këshilluese e NALT-it për FSK-në. Në vazhdim gjeneral Oberneyer siguroi se mbështetja e NALT-it do të vazhdojë edhe më tej dhe falënderoi udhëheqjen e FSK-së për bashkëpunim si dhe uroi për sukseset e deritashme edhe pjesëmarrësit e Konferencës. Në vazhdim të punimeve të Konferencës kolonelët: Hasan Hoxha e Haki Hoti, dhe majori Dedë Hyseni paraqitën prezantimet: Bashkëpunimi Ndërkombëtar, Procesi i Tranzicionit të FSK-së dhe Plani Vjetor 2020 me projeksionet edhe për periudhën 2021-2023. Në sesionin e pasdites, përfaqësuesit e delegacioneve nga vendet partnere prezantuan aktivitetet e realizuara të planeve të bashkëpunimit dypalësh me FSK-në për vitin 2019 dhe aktivitetet kryesore të planifikuara në planet e vitit 2020. Për të finalizuar punimet e Konferencës, në delegacione të ndara u realizuan takime dypalëshe veç e veç ndërmjet delegacioneve të FSK-së dhe delegacioneve të vendeve partnere. Në këto takime u analizuan dhe vlerësuan fushat në të cilat nevojitet mbështetja e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së në zhvillimin e aftësive për periudhën 3-vjeçare me finalizimin e planet dypalëshe për vitin 2020 dhe hartimin e koncept-planit për periudhën 2021-2023.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma “Adem Jashari”, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ministri Berisha dhe gjenerali Rama nderojnë ushtarët britanikë të rënë në Kosovë në shërbim të paqes



Prishtinë, 11 nëntor - Ministri i Mbrojtjes z. Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama, vendosën kurora lulesh në nderim të 14-të anëtarëve të Forcave të Armatosura britanike, që humbën jetën në Kosovë gjatë shërbimit me forcat e NATO-s. Ceremonia u organizua nga Ambasada Britanike në Prishtinë, në të cilin morën pjesë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve në vend, ambasadorë, ushtarakë si dhe personalitete të tjera. Përkujtimi për të rënët shënohet çdo vit, të dielën më të afërt me 11 nëntorin, ditën kur u shënua fundi i Luftës së Parë Botërore.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent ndan mirënjohje për QNTKSH



Prishtinë, 11 nëntor-Në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QNTKSH) të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Pomozotin, zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (AME) z. Shefki Abdullahu ndau mirënjohje për Drejtorinë e QNTKSH-së. Mirënjohje i është ndarë QNTKSH-së për kontributin e saj në bashkëpunimin dhe ngritjen e kapaciteteve ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe AME-së. Prezantimi u mbajt në përfundim të trajnimit rreth kërkim-shpëtimit në ujërat të shpejta ku morën pjesë 15 pjesëtarë të FSK-së, 2 nga ekipi i zjarrfikësve dhe 2 oficerë të Policisë së Kosovës. Përmbajtja e trajnimit është projektuar dhe zhvilluar nga instruktorë të QTKSH-së, bazuar në përvojat e fituara nga trajnimet e zhvilluara nga shtetet partnere të NATO-së. Ky trajnim është zhvilluar në pjesën teorike dhe atë praktike, ku pjesëmarrësit mësuan nw baza shkencore për ujërat e rrëmbyeshëm dhe karakteristikat e tyre, se si të përballën me pengesat dhe rreziqet që shkakton uji i rrëmbyeshëm, përpara se të ndodhin në praktikë. Skenarët rreth stërvitjeve praktike janë kryer gjatë tri ditëve sfiduese për të shpëtuar viktimat, duke aplikuar këtu përdorimin e teknikave mbrojtëse gjatë ballafaqimit me ujëra të rrëmbyeshëm dhe pengesa të tjera në lumenj.

Në Forcën e Sigurisë së Kosovës mbahet „Konferenca e EOD-së“



Prishtinë, 08 nëntor - Në kazermën „Lidhja e Prizrenit“ të Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prizren, u mbajt “Konferenca e EOD-së”. Në takimin e përbashkët të aktorëve kryesorë, që ndër vite kanë kontribuar në pastrimin e fushave të rrezikshme në Kosovë, që janë: Kompania e Deminimit e FSK-së, Qendra Koordinuese për Deminim (QKD), njësitet e EOD-së të shteteve të ndryshme që janë pjesë e KFOR-it, si: EOD-SHBA, EOD-UKRAINA, EOD-MOLDAVIA, EOD-AUSTRIA, Skuadra e Bombave nga Policia e Kosovës, përfaqësues nga Komanda e Lartë e KFOR-it, ushtria franceze dhe ajo italiane dhe organizata MAT-Kosova. Gjatë konferencës u prezantuan të arriturat e ekipeve pjesëmarrëse në pastrimin e hapësirave të dyshimta dhe shkatërrimin e mjeteve të rrezikshme në Kosovë, kapacitetet aktuale si dhe planet për të ardhmen. Komandanti i Kompanisë së Deminimit majori Gëzim Sada, në emër të komandantit të Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Xhevahir Geci, ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre të dhënë për pastrimin e Kosovës nga mjetet e rrezikshme: „Faleminderit dhe respekt për njerëzit tuaj. Me punën tuaj që keni bërë deri më tani dhe po vazhdoni ta bëni, Kosova dhe populli i saj, po ndihen më të sigurt dhe më të pa rrezikuar nga minat dhe mjetet eksplozive të pashpërthyera (MEP). Falë bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave mes nesh, kemi arritur të pastrojmë miliona metra katrorë sipërfaqe të rrezikshme dhe kemi asgjësuar mijëra MEP, pa asnjë aksident”,- tha në fund majori Gëzim Sada.
Ndërsa, nënkoloneli amerikan Todd Wssing vlerësoi lart punën e njësive të EOD-së të FSK-së, duke shprehur mirënjohje për punën humane që ata po bëjnë në Kosovë.
Gjithashtu një kontribut të madh, në aspektin profesional, në konferencë dhanë edhe pjesëmarrësit tjerë. Konferenca i përmbylli punimet me zotimin për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, që Kosova të jetë një vend sa më i sigurt nga minat dhe mjetet tjera eksplozive të pashpërthyera.

Bashkëpunim i frytshëm i Policisë Ushtarake të FSK-së me Policinë Ushtarake të FARSH-së



Prishtinë, 15 nëntor - Një delegacion i Policisë Ushtarake të Forcës së Sigurisë të Kosovës me ftesë të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ditë më parë, ka qëndruar për vizitë zyrtare dyditore në Tiranë. Delegacioni i FSK-së, i cili kryesohej nga komandanti i PU-së, major Besnik Selimi, u prit nga komandanti i PU-së të FARSH-së, kolonel Altin Kurti dhe stafi i tij. Gjatë takimit, të dy komandantët biseduan për mundësitë e organizimit dhe realizimit të trajnimeve të përbashkëta, si dhe për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi ndërmjet dy forcave ushtarake. Gjithashtu, delegacioni i FSK-së, nga mikpritësit, u njoftua me organizimin, misionin, detyrat dhe funksionimin e PU-së të FARSH-së. Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit që ka FSK-ja me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe ngritjes së profesionalizmit të Policisë Ushtarake të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Në Kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë

FSK-ja shënoi Ditën e Forcës me ceremoni ushtarake

Prishtinë, 27 NËNTOR - Në kazermën „Adem Jashari“në Prishtinë, me ceremoni ushtarake u shënua 27 Nëntori-Dita e Forcës. Njësitet e FSK-së, parakaluan me emblema, flamuj dhe grada të reja. Ceremonia për shënimin e një-vjetorit të themelimit të ushtrisë së Kosovës, filloi me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të FSK-së, nga presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama.

Me këtë rast, presidenti Hashim Thaçi, në fjalën e tij, drejtuar oficerëve dhe nënoficerëve të ushtrisë së Kosovës, tha: „Dita e FSK-së e gjen Republikën e Kosovës në ditë zie nga tërmeti i djeshëm, i cili mori dhjetëra jetë të vëllezërve dhe motrave tona. Ditën e Forcës po e shënojmë si ditë të ushtrisë të Republikës së Kosovës, që është në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj. Ushtria e Kosovës gëzon besim nga të gjithë qytetarët, është bërë institucioni që kontribuon për paqe dhe stabilitet në Kosovë. Kudo që kanë qenë pjesëtarët e FSK-së, së fundi edhe në garat ndërkombëtare me prestigjioze të



mbajtura në Britaninë e Madhe, kanë shkëlqyer“. „FSK-ja është fuqia dhe garancia më e mirë e sigurisë dhe stabilitetit të Kosovës“, -tha në fund presidenti Hashim Thaçi.

Ndërsa, kryeministri i Kosovës z. Ramush Haradinaj, në fjalën e tij tha: „Jam krenar sot që ushtria jonë është vlerë e sigurisë në rajon e në botë. Jam i lumtur që ky rreshti ynë i paqes, nderojnë Kosovën dhe aleatët e lirisë“. Kurse, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, së pari ua uroi Ditën e Forcës të gjithë oficerëve dhe nënoficerëve të saj, për të shtuar më pas: „ Është nder i veçantë, por njëkohësisht edhe privilegj për mua, t'ju drejtohem sot në cilësinë e komandantit të Forcës së Sigurisë të Kosovës me rastin e ditës më të rëndësishme - Ditës së Forcës. 27 Nëntori është dita kur unë së bashku me secilin ushtarak të FSK-së, nga pozicioni dhe përgjegjësia jonë zyrtare, profesionale e morale, kujtojmë atë që kaluam dhe bëmë së bashku dhe, njëkohësisht, së bashku do të vazhdojmë të reflektojmë për rrugën që do të trasojmë.“ Komandanti i FSK-së, më tej, shtoi se: „Pas një rrugëtimi krah për krah me partnerët tanë arritëm që vitin e kaluar më 14 dhjetor të kurorëzojmë objektivin tonë madhor me vendimin e Kuvendit tonë, dhe më 21 janar të këtij viti të nisim procesin e tranzicionit bazuar në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit“. Duke iu drejtuar të pranishmëve, gjeneral Rama tha: „Të nderuar të pranishëm, 14 dhjetorin e vitit 2018–ditën e miratimit të tri ligjeve, që e legjitimojnë vullnetin tonë për mandatin ushtarak të FSK-së, të gjithë së bashku e përjetuam si ngjarjen më të rëndësishme shtetërore pas 17 Shkurtit-ditës kur u shpall Pavarësia e Kosovës. Prandaj me krenari ju njoftoj se FSK-ja brenda kësaj periudhe ka arritur që të realizojë themelimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe kapacitetet themelore të Gardës Kombëtare, Komandën e Logjistikës, Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe të njësive pranshtabore. Krahas këtyre, FSK-ja ka realizuar me sukses planin vjetor të rekrutimit duke rekrutuar rreth 700 ushtarë të rinj,



Rekrutët e rinj të FSK-së dhanë betimin

Prishtinë, 15 NËNTOR - Në kazermën „Adem Jashari“ të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë, sot u mbajt ceremonia e betimit të 337 rekrutëve të rinj, gjenerata e dytë e FSK-së, pas përfundimit të trajnimit bazik nëntë-javorë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Në fjalën e tij, zv.ministri Burim Ramadani, pasi përshëndeti të pranishmit në emër të ministrit të Mbrojtjes, tha se: „sot për mua, sikurse për të gjithë ne, është një ditë e veçantë". Ai duke ju drejtuar të pranishmeve shprehet se „aseti më i çmuar i FSK-së janë vetë pjesëtarët e saj profesionistë - ushtarët, nënoficerët dhe oficerët. Jo rastësisht Forca e Sigurisë është institucioni më i besueshëm në Kosovë për gati një dekadë me radhë. FSK-ja sot është profesionale, e besueshme, shumetnike, e gatshme për të ndihmuar paqen dhe sigurinë në vend, në rajon dhe kudo nëpër botë". Zv. ministri Ramadani duke ju drejtuar rekrutëve tha: „Ju po



bëheni pjesë e Forcës sonë në një etapë të rëndësishme për të ardhmen tonë të përbashkët. Në kohën kur tranzicioni ushtarak i FSK-së është në rrugë të mbarë, kur Ministria e Mbrojtjes po konsolidohet dhe FSK-ja po rritet e forcohet. Vizioni ynë është që Kosova të jetë e sigurt, e mbrojtur dhe me prosperitet". Në fund, zv. ministri Ramadani tha se „Vullneti ynë është bashkëpunimi me të gjithë në rajon, të bindur se kjo i ndihmon paqes. Interesi ynë nacional është konsolidimi i plotë i shtetit tonë. Rruga jonë përpara është thellimi i partneritetit strategjik me SHBA-të dhe anëtarësimi në NATO". Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij, tha: „Kam kënaqësinë dhe nderin që si Komandant i FSK-së, t'ju drejtohem juve ushtarë të nderuar, për përfundimin me sukses të trajnimit bazik. Ju zgjodhët një profesion fisnik për t'i shërbyer vendit dhe qytetarëve të Kosovës pa dallim, dhe për këtë ju duhet të ndiheni krenarë". Komandanti i FSK-së, më tej shtoi se; „FSK-ja është një forcë e besueshme, shumetnike, e trajnuar dhe e pajisur me standardet e NATO-s, transparente dhe e gatshme të koordinohet me të gjithë partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Sot, FSK-ja ka kapacitetet e specializuara që mund të ndihmojnë paqen dhe sigurinë kudo në botë krah për krah me ushtarët e vendeve të NATO-s". Gjenerali Rrahman Rama foli edhe për suksesin e FSK-së gjatë këtij viti. „Ne po e përmbyllim edhe një vit të suksesshëm. Po punojmë ngushtë me partnerët tanë strategjikë që FSK-ja të jetë e trajnuar sipas standardeve të NATO-s dhe e gatshme për operacione që garantojnë paqe e stabilitet në rajon e më gjerë". Gjenerali Rrahman Rama, duke ju drejtuar rekrutëve tha; „Gjatë karrierës tuaj, ju do të ballafaqoheni me sfida të ndryshme, andaj nga ju pritet që të jeni të disiplinuar, të përkushtuar dhe gjithmonë të përgatitur t'i kryeni detyrat sipas udhëzimeve të eprorëve tuaj". Në fund komandanti i FSK-së, përgëzoi stafin e KDS-së, për kontributin e tyre profesional në zhvillimin e të gjithë pjesëtarëve të FSK-së, si dhe familjarët e rekrutëve për mbështetjen e tyre gjatë shkollimit. Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu, bazuar në rezultatet e treguara të rekrutëve gjatë trajnimit bazë, shpërbleu me lëvdata këta rekrutë: Behar Gashin, Hashif Avdiun, Ardian Mziun, Dardan Krasniqin, Alfred Hazirajn, Elvis Haxhollin, Valdrin Selimin dhe Liridon Bekën, ndërkaq për arritje të larta fizike shpërbleu rekrutët: Fisnik Hysenin dhe Vijona Kryeziun. Në fund të ceremonisë dhanë betimin 337 rekrutë të rijnë, prej tyre 251 meshkuj, 47 femra dhe 38 pjesëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë.







duke ngritur përqindjen e përfaqësimit të komuniteteve në mbi 10% e sidomos atë të komunitetit serb, si dhe duke ngritur përqindjen e gjinisë femërore në mbi 11%. Ditën e Forcës sonë si gjithherë e kremtojmë bashkë me partnerët tanë në nivel dypalësh, me Ekipin Këshillëdhënës të

je të thellohet edhe më tej, sepse është aspirata jonë që edhe zyrtarisht të integrohemi në familjen e përbashkët të Aleancës Veri Atlantike". Gjeneral Rama tha se FSK-ja është e gatshme dhe e përgatitur profesionalisht për të marrë pjesë në operacione humanitare. „Se FSK-ja është

tërmetit në disa vendbanime në Shqipëri, ku kontingjenti i Task-Forcës sonë, arriti që të parët të dislokohen në zonat e dëmtuara dhe të fillojnë menjëherë operacionet e kërkim–shpëtimit urban, dhe siç jam deklaruar edhe dje, varësisht prej nevojave që do të paraqiten në terren, ne jemi të gatshëm të përg-

oficerëve të FSK-së, tha: „Sot ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FSK-së janë më të përgatitur, më të trajnuar e arsimuar dhe më të pajisur, por megjithatë jam i ndërgjegjshëm se ende mbetet për t'u bërë. Forcat tona po zhvillohen më tej, me vizion të qartë bazuar në koncepte bashkëkohore dhe profesion-

e modernizimit të mëtejmë. Urime Dita e Forcës dhe na priftë e mbara në rrugëtimin drejtë qëllimit tonë të përbashkët".

Në fund të ceremonisë, para të pranishmeve u lexuan urdhrat e Presidentit Thaçi, Ministrit Berisha dhe Komandantit Rama, për ndarjen e mirënjohjeve dhe medaljeve për gjeneralë, oficerë, nënoficerë dhe ushtarë të dalluar të Ministrisë dhe FSK-së.





NATO-s dhe me KFOR-in që gjithmonë ishin dhe janë me ne gjatë tërë rrugëtimit tonë. Ky partneritet do të vazhdo-

e përgatitur dhe e gatshme për pjesëmarrje efektive në operacione humanitare u dëshmua edhe dje, pas

Tetari Arian Zabeli dekorohet nga ushtria amerikane me çmimin „Gung Ho Award"



NËNTOR - Nënoficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, tetari Arjan Zabeli, përfundoi me sukses të lartë trajnimin „Advanced Infantry Marine Course" në Bazën e Marinës së ushtrisë amerikane në SHBA. Gjatë shkollimit, në SHBA, tetar Zabeli në të gjitha fazat e trajnimit ka treguar paraqitje të shkëlqyer duke u renditur si njëri nga studentët me vlerësimet më të larta. Për paraqitje të

shkëlqyeshme dhe arritje të rezultateve të veçanta gjatë trajnimit për udhëheqje (liderships) në SHBA, tetari Arian Zabeli nderohet me çmimin „Gung Ho Award". Sukseset e pjesëtarëve të FSK-së, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, janë treguesit më të mirë për progresin të cilin po e arrin Forca e Sigurisë së Kosovës në krijimin dhe avancimin e kapaciteteve të përgjithshme.

Togeri Xhevahir Hasanaj dekorohet nga ushtria e SHBA-ve

Prishtinë, 18 NËNTOR - Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, togeri Xhevahir Hasanaj, përfundoi me suksese të lartë trajnimin „Civil Affairs" që realizohet në Qendrën dhe Shkollën për Luftëra Speciale (Special Warfare Center and School) „John F. Kennnedy" e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Toger Hasanaj ka treguar paraqitje të shkëlqyer në të gjitha fazat e shkollimit, duke u renditur si njëri nga studentët me vlerësimet më të larta. Si rezultat i paraqitjes së lartë; pas përfundimit të trajnimit, togeri Xhevahir Hasanaj u dekorua me medaljen e meritave „Commendation Medal" dhe



mori çmimin „Distinguished Honor Graduate". Arritjet e shkëlqyeshme gjatë shkollimit për togerin Xhevahir Hasanaj, janë në vazhdën e suksesseve të tjera, si fitimi i çmimit „Kadeti më i mirë i huaj në fushën ushtarake, akademike dhe praktike" në vitin 2017, gjatë shkollimit në Akademinë Mbretërore Sandhurst të Mbretërisë së Bashkuar.

Në Mistrinë e Mbrojtjes mbahet „Forumi i nënoficerëve të lartë“



Prishtinë, 21 NËNTOR - Në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, u mbajt „Forumi i nënoficerëve të lartë“, në të cilin morën pjesë mbi 40 nënoficerë të FSK-së, SHBA-ve, KFOR-it, NALT-it dhe vendeve të tjera partnere të FSK-së. Qëllimi i këtij forumi ishte që të ndahen përvojat me partnerët ndërkombëtarë duke pasur në fokus rritjen dhe zhvillimin e trupës së nënoficerëve në përgjithësi. Ky forum ishe i organizuar në formën e diskutimit të hapur, ku të gjithë të pranishmit patën rastin të diskutojnë lidhur me arritjet në vendet e tyre, por edhe për sfidat me të cilat ata përballen. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë punimeve të forumit i përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit dhe njëherësh i falënderoi për ndihmën që shtetet e tyre kanë dhënë për FSK-në, në veçanti falënderoi NATO-n, KFOR-in, SHBA-të dhe të gjitha shtetet aleate. Gjenerali Rrahman Rama, gjatë fjalës së tij tematike, veç tjerash tha: „Falë angazhimit, përkushtimit dhe përkrahjes së partnerëve tanë, si FSK jemi shumë krenarë me të gjitha të arriturat, këtu hyjnë edhe të arriturat e Korit të nënoficerëve i cili vazhdon të mbetet prioritet për ne. Jemi ushtria më e re në botë dhe kemi mësuar nga të gjithë Ju. Eksperiencat që do t'i ndajmë në këtë Forum janë shumë të rëndësishme për ne“. Më tej, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, foli edhe për zhvillimet e përgjithshme të FSK-së, duke nënvizuar të ardhmen e saj. „Orientimi ynë është shumë i qartë - integrimi në Aleancën Euro-Atlantike. Ne, gjithçka që kemi ndërtuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës, e kemi ndërtuar në bazë të standardeve të NATO-s.“ Gjithashtu, komandanti i FSK-së foli edhe për gatishmërinë e FSK-së për pjesëmarrje në misione ndërkombëtare kudo në botë. „Ne jemi të gatshëm të japim kontributin tonë krah për krah me partnerët tanë kudo që e kërkon nevoja për paqe në Botë“. Ndërsa, rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj, pasi përshëndeti oficerët e lartë pjesëmarrës nga Kanadaja, SHBA-të, Sllovenia, Hungaria, Zvicra, Norvegjia, Austria, Irlanda, Italia etj., prezantoi sistemin e edukimit dhe të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Mysafir nderi i këtij forumi ishte rreshter majori Alain Guimond nga Kanadaja, i cili mbajti një ligjëratë me temën: „Sistemi i edukimit, karriera dhe autoriteti i NOF“. Në Forum gjithashtu ligjëruan edhe rreshter majori i Komandës së KFOR-it, Davide Campisi dhe rreshter majori i NALT-it, (Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s në FSK) Janez Smid. Në fund të forumit u tha se rezultatet dhe përvojat e këmbyera gjatë punës së forumit janë të rëndësishme në misionet ndërkombëtare, ku kërkohet bashkëveprim dhe bashkërendim ndërmjet ushtarëve dhe ushtrive aleate.

Instruktorët amerikanë trajnojnë pjesëtarët e FSK-së për ngasjen dhe mirëmbajtjen e automjeteve „HMMWV“



Prishtinë, 01 nëntor - Në kazermën „Adem Jashari“ të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë, sot përfundoi trajnimi për operatorë të automjeteve speciale „HMMWV“, i cili ka filluar më 28.10.2019 dhe është realizuar nga instruktorë të DOD-it të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Ky trajnim është planifikuar të realizohet në dy faza. Faza e parë e trajnimit, e cila ka përfunduar sot, ka përfshirë pjesën praktike për ngasje të HMMWV, e cila është realizua në kazermën „Adem Jashari“ dhe në malin e Gërmisë në Prishtinë, ndërsa faza e dytë e trajnimit do të përfshijë pjesën e mirëmbajtjes së automjeteve dhe do të fillojë më 4 nëntor dhe do të zgjasë deri më 8 nëntor 2019. Për pjesëtarët të cilët ishin pjesë e këtij trajnimi u ndanë certifikata, më ç 'rast, përgjegjësi i këtij ekipi, togeri Qëndrim Kastrati, pasi i falënderoi trajnerët që dhanë shumë nga eksperienca e tyre për pjesëtarët e FSK-së, e cilësoi lart rëndësinë e trajnimit edhe për ushtarakët e FSK-së. Realizimi i këtij trajnimi u bë falë bashkëpunimit dypalësh që ka FSK-ja me SHBA-të, me qëllim të aftësimit dhe ngritjes profesionale të pjesëtareve; në këtë rast, aftësimin e tyre në ngasjen dhe mirëmbajtjen e këtyre automjeteve të FSK-së

FSK-ja zhvillon dy operacione për zhvendosjen dhe deponimin e materieve të rrezikshme



Prishtinë, 22 NËNTOR - Kompania e Materieve të Rrezikshme (KMRR) e Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) e Gardës Kombëtare (GK), gjatë këtij muaji ka zhvilluar dy operacione të rëndësishme për zhvendosjen dhe deponimin e materieve të rrezikshme. Njëri operacion është kryer në QKUK dhe tjetri në fabrikën e tekstilit në Gjakovë. Në periudhën prej 14 deri më 20 nëntor 2019, një skuadër e Kompanisë së Materieve të Rrezikshme, ka zhvilluar operacionin e zhvendosjes dhe deponimit të materieve të rrezikshme (mbetje si reagenca që janë përdorur në zhvillimin e analizave laboratorike) nga Reparti i Biokimisë në QKUK për në sanatorium (lokacionin brenda QKUK-së). Ky operacion ka përfunduar me mjaft sukses. Ndërkaq, që nga data 11 nëntor 2019 është duke u zhvilluar operacioni i ri-ambalazhimit dhe deponimit të materieve të rrezikshme në „Devolli Corporation“, ish-fabrika e tekstilit „Emin Duraku“ në Gjakovë. Ky ri-ambalazhim dhe deponim ka rrjedhur si rezultat i inspektimeve të vazhdueshme nga Kompania e Materieve të Rrezikshme, me qëllim të reduktimit të rrezikut nga kontaminimi i mëtutjeshëm. Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë profesionale, e përgatitur mirë dhe e gatshme që t'iu përgjigjet të gjitha sfidave të sigurisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës me të gjitha kapacitetet e saj.

Batalioni i Parë i BRSH-së përfundoi ushtrimin fushor „PARTNERËT 19“



Prishtinë, 19 NËNTOR - Ditë më parë, Batalioni i Parë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, në nivel të Kompanisë, në bashkëpunim me Komunën e Vitisë, Komunën e Kamenicës dhe njësitë e tyre emergjente kanë realizuar ushtrimin fushor „PARTNERËT 19“. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit kanë arritur një bashkëpunim të shkëlqyer në shkëmbimin e përvojave në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të ushtrimeve të tilla. Ushtrimi është realizuar në periudha të ndryshme kohore. Në Komunën e Vitisë është mbajtur nga data 04-08 nëntor, ndërsa në Komunën e Kamenicës nga data 11-15 nëntor. Pjesë e këtij ushtrimi, në rol vëzhgues, ishin edhe Komuna e Kllokotit dhe ajo e Artanës, me qëllim të informimit dhe familjarizimit me skemën e mobilizimit dhe reagimit të përbashkët në situata emergjente. Ushtrimi me autoritetet civile është planifikuar dhe ekzekutuar sipas Planit të Reagimit Kombëtar dhe Sistemit të Integruar të Emergjencave, dokumente këto obliguese për bashkëveprim në situatat të ndryshme të emergjencave civile. Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë edhe njësitë e specializuara të Gardës Kombëtare, Skuadra e Kërkim-Shpëtimit, EOD-ja, MKABK-ja dhe K9-ta.

QNTKSH-ja mban trajnim për punonjësit e GIZ-it lidhur me tërmetet



Prishtinë, 15 nëntor - Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit për Kërkim Shpëtim (QNTKSH) e Forcës së Sigurisë të Kosovës, për tri ditë, ka mbajtur trajnim për 70 punonjës të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) lidhur me tërmetet . Tërmetet janë diçka që nuk mund të evitohen dhe mund të ndodhin në çfarëdo kohe, nganjëherë me efekte shkatërruese dhe qëllimi i programit ka qenë të ngritët siguria dhe fleksibiliteti i stafit të GIZ-it në rast të ndonjë tërmeti. Trajnimi është fokusuar në karakteristikat e tërmetit, veprimet që duhet të ndërmerren në rast tërmeti, sa duhet pritur dhe çfarë duhet bërë në rast të tilla? Në programin e trajnimit është përfshirë edhe tema se çfarë duhet bërë për të zvogëluar dëmet e tërmetit? Gjatë trajnimit interaktiv, instruktorët e QNTKSH-së kanë marrë shembuj dhe skenarë nga përvojat e tyre jetësore. Drejtori i GIZ-it për Kosovë, David Oberhuber, tha: „Kolegët tanë të QNTKSH-së janë shumë të përkushtuar dhe kompetentë. Ata kanë bërë një punë të madhe për ndërgjegjësimin e stafit tonë lidhur me situatat ekstreme siç janë tërmetet. Ne si organizatë duhet të kujdesemi për mirëqenien e punonjësve tanë në rast emergjencash.” GIZ-i operon në Kosovë duke përfaqësuar Ministrinë Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim qysh nga viti 1999, në fushën e punësimit dhe mirëqenies, sundimit të ligjit, agjendës evropiane, edukimit, shkencës, kulturës, rinisë dhe sportit. Tani fushat me prioritet janë bashkëpunimi i Gjermanisë me Kosovën për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe promovim rajonal të ekonomisë, trajnime profesionale, administratë publike, reforma në sistemin e financave publike, reformave ligjore, efikasitet të energjisë dhe integrim në BE. Në vazhdën e suksesit të këtij trajnimi, bisedimet për të ardhmen në fushat e bashkëpunimit dhe trajnimeve në mes të QNTKSH, GIZ-it dhe organizatave të tjera ndërkombëtare veçse kanë filluar.

Pjesëtarët e FSK-së certifikohen në trajnimin „Komando dhe Bjeshkatari“





Prishtinë, 12 nëntor - Në kazermën „Ushtarët e NATOS“ të Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë në Istog, dje u mbajt ceremonia e certifikimit të 25 pjesëtarëve të Bat-2 të Kompanisë 2A, K 2B, K2C dhe K2MB, të cilët përfunduan trajnimin „Komando dhe Bjeshkatari“ nga data 16.09.2019 - 11.11.2019, të realizuar nga instruktorët e Ekipit Trajnues Turk. Trajnimi përfshin pjesën teorike dhe atë praktike të ndarë në dy faza: Faza e parë e trajnimit ishte „Komando“, ku, për qëllim kishte avancimin e shkathtësive për detyra individuale dhe kolektive në zhvillimin e operacioneve luftarake dhe zhvillimin e aftësive për reagim në situata të paparashikueshme, kurse faza e dytë ishte „Bjeshkatari“, ku pjesëtarët u përgatitën që të veprojnë në kushte të ndryshme të terrenit dhe avancimin e shkathtësive për operim në vendet kodrinore-malore. Programi i trajnimit „Komando dhe Bjeshkatari“ përfshin temat si: navigimi tokësor ditën dhe natën, kalimi i poligonit të kalitjes, taktikat e qitjes me avancim individual në qifte, me skuadër dhe me togë, lëvizjet taktike (individuale, ekip, skuadër dhe togë, kërkim dhe kordon), repelimi nga vende kodrinore-malore dhe aktivitete sfiduese fizike, përfshirë marshime të vazhdueshme në distanca të gjata dhe vrapim me pajisje ushtarake deri në 27 km. Në ceremoninë e certifikimit të pranishëm ishin: zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral majori Enver Cikaçi, komandanti i BRSH-së, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, komandanti i Batalionit të Dytë, nënkolonel Astrit Haliti, nga KFOR-i turk ishte i pranishëm koloneli Numan Bash, po ashtu atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovë, Ismajl Gjenkeri si dhe këshilltari i KOMFSK-së Erhan Bahtir. Zëvendëskomandanti i FSK-së, gjenerali Enver Cikaqi, pasi falënderoi Ekipin Trajnues Turk për kontributin e dhënë në realizimin e objektivave gjatë trajnimit, foli edhe për rëndësinë e arritjes së objektivave trajnuese të këtij trajnimi si dhe përgëzoi pjesëtarët e FSK-së për sukseset e arritura. Ndërsa, komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hadërgjonaj përgëzoi KOMBAT-2 për të arriturat e vazhdueshme të BAT-2 dhe punën e tyre të palodhshme, si dhe falënderoi Ekipin Trajnues nga Turqia, për kontributin e dhënë në trajnimin e pjesëtarëve të BRSH-së dhe të FSK-së. Trajnimet e tilla sfiduese po tregojnë që pjesëtarët e FSK-së janë të përgatitur profesionalisht dhe kanë kapacitete që të zhvillojnë operacione për t’iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ushtrimi fushor „ NËNTORI 2019 “ ushtrim i suksesshëm i Batalionit të Dytë të BRSH-së



Prishtinë, 21 NËNTOR - Batalioni i Dytë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH-së), nga data 19-21.11.2019, ka zhvilluar me sukses ushtrimin fushor „Nëntori 2019“. Më këtë ushtrim, Kompania 2B e ka përmbyllur trajnimin e gjenerimit të forcës, i cili ka filluar më 09.09.2019 dhe ka përfunduar më 21.11.2019. Batalioni i Dytë, me vendqëndrim të përhershëm në kazermën „Ushtarët e NATO-s“ në Istog, ka intervenuar në të gjitha vend-incidentet e parapara në Planin e këtij ushtrimi fushor, i cili u realizuar në territorin e Komunës së Istogut dhe asaj të Klinës. Qëllimi i këtij ushtrimi ishte testimi i gatishmërisë së personelit i Kompanisë 2A, Kompanisë 2B, Kompanisë 2C, Kompanisë Mbështetëse si dhe Skuadrës Mjekësore në intervenime si: operacione urbane; pikë kontrolli; sulm në nivel skuadre-togu; pritë, okupim i bazës patrulluese, patrullim, kordon- kërkim, ngritja e pikës së vëzhgimit etj., duke iu dhënë liri veprimi të gjithë liderëve në të gjitha nivelet e komandimit, gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të operacioneve, të aplikojnë komandimin në mision. Pjesëtarët e Batalionit të Dytë dëshmuan profesionalizëm dhe motivim të lartë gjatë realizimit të operacioneve të stërvitjes në këtë ushtrim. Ushtrimi fushor „Nëntori 2019“ u përcoll nga zëvendëskomandanti i BRSH-së, kolonel Hysen Dreshaj dhe komandanti i BAT-2, nënkolonel Astrit Haliti. Koloneli Dreshaj e përgëzoi Batalionin e Dytë për profesionalizmin, gatishmërinë dhe motivimin e treguar gjatë realizimit të këtij ushtrimi, dhe njëherësh kërkoi nga kompanitë pjesëmarrëse që të vazhdojnë me përkushtim përmbushjen e obligimeve dhe kryerjen e detyrave në të ardhmen. Ndërsa, nënkoloneli Astrit Haliti e vlerësoi ushtrimin si mjaft të suksesshëm dhe me objektiva të arritura. Ai veç tjerash shprehet se „ky ushtrim fushor dëshmon që BAT-2 është i gatshëm dhe ka kapacitete që të zhvillojë operacione për t’ iu dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës, në Zonën e përgjegjësisë të cilën e mbulon“.

FSK-ja organizoi gara sportive për nder të “Ditës së Forcës”





Prishtinë, 26 NËNTOR - Në kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë sot u mbajt ceremonia e përfundimit të garave sportive të realizuara për nder të 27 Nëntorit-“Ditës së Forcës”. Garat sportive u realizuan në mjediset e FSK-së nga 4 deri më 25 nëntor 2019 në këto disiplina: Futboll i vogël, Volejboll, Ping Pong, Shenjëtari, Shah dhe Kros. Sot në ceremoninë përmbyllëse të këtyre garave të pranishëm ishin zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneral major Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Logjistikës gjeneral brigade Naim Haziri, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Gjatë ceremonisë të gjitha vendet e para nga të gjitha disiplinat u shpërblyen me medalje, ndërsa mirënjohje morën të gjithë ata që kontribuuan në realizimin e këtyre garave mjaft të rëndësishme të zhvilluara në prag të festave të Nëntorit dhe “Ditës së Forcës”. Ekipet fituese sipas disiplinave u shpallën si në vijim: Në Futboll të vogël, vendin e parë e zuri Regjimenti i Qëndrueshmërisë së Komandës së Logjistikës, vendin e dytë Policia Ushtarake, vendin e tretë Batalioni i Parë i BRSH-së. Ndërkaq portieri më i mirë u përzgjodh Florent Sadiku dhe lojtari më i mirë, njëherësh edhe golashënuesi më i mirë Arbenis Demaku. Në Volejboll, vendin e parë e zuri Batalioni i Dytë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, vendin e dytë Kompania Mbështetëse e Shtabit të Përgjithshëm dhe vendin e tretë Regjimenti i Qëndrueshmërisë së Komandës së Logjistikës. Në Ping Pong, vendin e parë e zuri OR7 Arsim Idrizi, vendin e dytë OR3 Izet Dermjani dhe vendin e tretë Shpetim Hasani. Në Shenjëtari, vendin e parë e zuri OF2 Alban Bujupi; vendin e dytë OR8 Enver Bajraktari dhe vendin e tretë OR3 Agron Neziri. Në Shah, vendin e parë e zuri OR7 Ferit Zhdrella, vendin e dytë OR3 Arsim Kelmendi dhe vendin e tretë OR5 Demë Hoxha. Në Kros, vendin e parë në kategorinë e meshkujve e zuri OR1 Armend Neziraj, vendin e dytë OR1 Alban Fazliu dhe vendin e tretë OR1 Gent Dakaj, ndërsa në kategorinë e femrave vendin e parë e zuri OR1 Endrita Brahimi, vendin e dytë OR5 Ermira Statovci dhe vendin e tretë OR5 Mimoza Morina. Forca e Sigurisë e Kosovës që disa vite me radhë është duke organizuar aktivitete të tilla sportive për nder të ditës së saj, 27 Nëntorit, më qëllim të aftësimit dhe ngritjes së qëndrueshmërisë së personelit në kryerjen e detyrave të tyre funksionale.






FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 87/1 • 27 Dhjetor 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

VITI 2019 - VIT I FORMIMIT TË MINISTRISË SË MBROJTËS DHE USHTRISË SË KOSOVËS



EMBLEMATË E USHTRISË SË KOSOVËS (FSK)




KOMANDA E FORCËS TOKËSORE


GARDA KOMBËTARE


KOMANDA E LOGJISTIKËS


KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES


QENDRA PËR STUDIME UNIVERSITARE



POLICIA USHTARAKE


NJËSIA E KOMUNIKIMIT


NJËSIA AJRORE


KOMPANIA E MJEKËSISË



REXHIMENTET LUFTARAKE


NJËSIA PËR OPERACIONE CIVILE


NJËSIA PËR MBROJTJE KIBERNETIKE

Botues: Ministria e Mbrojtes e Republikës së Kosovës
Kryetar i Këshillit Botues: Rrahman Rama - *Gjenerallejtënant*
Kyeredaktor përgjegjës: Ibrahim Shala
Redaksia: Ali Uka, Remzie Zeqiraj - *nënkolonel*, Vëllazërim Qerimi - *nënkolonel*,
Tone Gashi - *lektore* dhe Agron Murati - *fotograf*
Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Kazerma „Adem Jashari" Prishtinë • Tel: 038 551 379 • Web: mod.rks-gov.net
Shtypi: Printing Press - Prishtinë

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS VOTOI TRI PROJEKTLIGJET PËR MINISTRINË E MBROJTJES DHE FSK-në




Prishtinë, 14 dhjetor 2018 - Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës pas votimit në lexim të dytë, më datë 14 dhjetor 2018, miratuan me shumicë absolute të votave tri projektligjet bazë të FSK-së: **Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.**

PRESIDENTI DEKRETOI LIGJET QË ZYRTARIZOJNË KRIJIMIN E USHTRISË SË KOSOVËS

Prishtinë, 28 dhjetor 2018 - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, më 28.12.2018, në një ceremoni të organizuar në Presidencë, ka dekretuar tri ligjet bazë që e ndryshojnë mandatin dhe misionin e FSK-së. Ligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në ceremoninë solemne të organizuar me rastin e nënshkrimit të ligjeve për Ushtrinë e Kosovës ishte i pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama dhe kadetë të FSK-së.





FJALA E REDAKSISË

Departamenti për Marrëdhënie me Publikun i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Kosovës (FSK), në përmbyllje të vitit 2019, publikoi numrin festiv të revistës së ilustruar "FORCA JONË".

Botimi i revistës ushtarake „FORCA JONË" ka për qëllim që t'i informojë lexuesit e interesuar me aktivitetet e FSK-së me mision të ri, pra me misionin e saj ushtarak, si dhe me aktivitetet e Ministrisë së Mbrojtjes.

Si botues dhe si redaksi synojmë që „FORCA JONË" të jetë revistë periodike, e pasuruar me rubrika standarde dhe me një numër më të madh të faqeve dhe tirazhit.

Andaj, jemi të hapur për bashkëpunim me të gjithë ata që mund të na ofrojnë materiale profesionale, si brenda Ministrisë dhe Ushtrisë, ashtu edhe më gjerë.

ZBULOHET PLLAKA ME MBISHKRIMIN MINISTRIA E MBROJTJES

Prishtinë, 21 janar 2019 – Në një ceremoni të organizuar në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes z. Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, solemnisht zbuluan pllakën me mbishkrimin Ministria e Mbrojtjes. Në ceremoni të pranishëm ishin edhe zv. ministrat: Agim Çeku e Burim Ramadani, sekretari i përgjegjshëm z. Shkëlzen Sylaj, gjeneral Gëzim Hazrolli dhe gjeneral Zymer Halimi, si dhe stafit i lartë i Ministrisë dhe FSK-së. Ministri Berisha para mediave tha se: „sot është një ditë e veçantë për Ministrinë tonë, për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe që nga sot, do të ndryshojë emërtimi i Ministrisë në Ministri të Mbrojtjes.



Zyrtarisht nga sot, është dita e parë, kur fillon procesi i tranzicionit të Forcës së Sigurisë të Kosovës në ushtri të Kosovës.

PRESIDENTI DEKRETOI EMËRIMIN DHE GRADIMIN E GJENERALËVE TË USHTRISË SË KOSOVËS

Prishtinë, 13 gusht 2019 - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në mbështetje të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më datë 01 gusht 2019, ka bërë emërimin dhe gradimin e gjeneralëve të FSK-së, si më poshtë: gjeneral brigade Enver Cikaqi, gradohet në gradën gjeneralmajor dhe emërohet zëvendëskomandant i FSK-së; gjeneralmajor Bashkim Jashari emërohet Inspektor gjeneral në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes; gjeneralmajor Gëzim Hazrolli emërohet drejtor i Drejtorisë së Inteligjencës në Ministrinë e Mbrojtjes; gjeneral brigade Nazmi Brahimaj emërohet drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes; gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj emërohet komandant i Komandës së Forcave Tokësore; gjeneral brigade Xhevahir Geci emërohet komandant i Gardës Kombëtare; gjeneral brigade Naim Haziri emërohet komandant i Komandës së Logjistikës; gjeneral brigade Irfete Spahiu emërohet komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe kolonel Jeton Dreshaj gradohet në gradën gjeneral brigade dhe emërohet shef i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së. Dekretimi dhe emërimi i gjeneralëve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ushtrisë së Kosovës – FSK, ka hyrë në fuqi më 12 gusht 2019.




PËR MM-në DHE FSK-në 2019-TA VIT I SUKSESEVE TË MËDHA



Prishtinë, 27 dhjetor 2019 - Në Ministrinë e Mbrojtjes u mbajt takim me gazetarë dhe përfaqësues të mediave, të cilët kanë përcjellë aktivitet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së gjatë vitit 2019. Ministri Rrustem Berisha në adresimin e tij falënderoi mediat për informimin e qytetarëve dhe pasqyrimin e drejtë të aktiviteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të FSK-së gjatë vitit që po lëmë pas. Ai theksoi se kjo konferencë ka rëndësi të veçantë sepse në cilësinë e Ministrit të Mbrojtjes po u drejtohet mediave në njëvjetorin e tranzicionit të FSK-së me mandate ushtarak. Më tej ministri numëroi disa nga të arriturat kryesore gjatë këtij viti, ku përfshihen realizimi i plotë i objektivave të parapara gjatë vitit të parë të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së; avancimi i kapaciteteve operative; implementimi i strukturës së re organizative të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së. Ministri Berisha gjithashtu i njoftoi gazetarët se gjatë kësaj periudhe, njësive të FSK-së i janë shtuar edhe 900 pjesëtarë të rinj. Me rekrutimet e fundit, është rritur numri i pjesëtarëve të gjinisë femërore (11%) dhe pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë (rreth 10%) në strukturat e FSK-së. Ministri iu referua edhe sondazhit të fundit rreth besueshmërisë së institucioneve të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019. Ky sondazh, edhe këtë vit, e ka nxjerr FSK-në si institucionin më të besueshëm, me rritje në përqindjen e besueshmërisë krahasuar me vitin e kaluar. Është rritur edhe besueshmëria në FSK nga komuniteti serb në 12%. Kjo, sipas ministrit Berisha, është falë punës së të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së si dhe shërbyesve civilë të Ministrisë së Mbrojtjes. Ministri Berisha ritheksoi se një nga objektivat strategjik të Republikës së Kosovës është anëtarësimi në NATO. Në këtë frymë, Republika e Kosovës ka raporte veçanërisht të mira me shtetet fqinje anëtare të NATO-s dhe ato që synojnë anëtarësimin në këtë organizatë. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pasi përshëndeti gazetarët tha: Po e përmbyllim vitin e parë si ushtri e vendit me suksese të mëdha në të gjitha fushat. Ne, falë bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe angazhimit të pjesëtarëve të FSK-së, i kemi përmbushur të gjitha objektivat e planifikuara të FSK-së. Synimi ynë mbetet avancimi i ndërveprimit me forcat anëtare dhe partnere të NATO-s, si dhe pjesëmarrja jonë në operacionet paqeruajtëse të NATO-s, për të dhënë kontributin e përgjithshëm për paqe, siguri dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë. Në fund, komandanti i FSK-së duke i falënderuar gazetarët tha se, transparenca jonë dhe pasqyrimi juaj profesional ka mundësuar që publiku dhe qytetarët e vendit në përgjithësi të informohen në mënyrë korrekte. Kjo ka rezultuar me vlerësimin e FSK-së, për të tetin vit me radhë, si institucioni më i besueshëm i sigurisë në vend.



FSK-ja institucioni më i besueshëm i sigurisë për qytetarët e Kosovës



Prishtinë, 16 dhjetor 2019 - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, pas publikimit të edicionit të nëntë të Barometrit Kosovar të Sigurisë dhe publikimit të rezultateve, tregon se Forca e Sigurisë së Kosovës, edhe këtë vit (2019), për qytetarët e Kosovës doli të jetë institucioni më i besueshëm i sigurisë (81%) në vend. Ky rezultat padyshim është pasqyrim i aktiviteteve dhe punës me përkushtim të lartë në realizimin e detyrave të planifikuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës.

Komandanti i Komandës së Bashkuar i Aleancës në Napoli vizitoi FSK-në

Prishtinë, 22 maj 2019 - Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën në takim veç e veç komandantin e Komandës së Bashkuar të Aleancës në Napoli, admiralin James Foggo. Takimi ndërmjet ministrit Berisha, admiralit amerikan Foggo dhe gjeneral Ramës u fokusua në situatën e sigurisë në Kosovë e rajon, tranzicionin e FSK-së, bashkëpunimin dhe bashkërendimin me partnerët strategjikë, qëllimin e palëkundur të Kosovës për anëtarësim në NATO dhe fokusimin në ndërtimin e kapaciteteve që garantojnë paqen në vend, rajon e më gjerë. Ministri Berisha e njoftoi admiralin Foggo rreth procesit të tranzicionit të FSK-së dhe bashkërendimin me partnerët strategjikë, NATO-n, KFOR-in dhe NALT-in. Nga ana e tij, komandanti i Komandës së Bashkuar i Aleancës në Napoli, admirali James Foggo, përgëzoi ministrin dhe komandantin për të arriturat e FSK-së dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me ekipin e NALT-it. Në veçanti shprehu admirimin e tij për profesionalizmin e lartë të pjesëtarëve të FSK-së. Ndër të tjera, admirali e ka konsideruar sukses të jashtëzakonshëm të Kosovës pjesëmarrjen e FSK-së me dy kadetë në Akademinë Ushtarake Amerikane "West Point", si dhe në angazhimet tjera në të mirë të zhvillimit të gjithmbarshëm të institucionit dhe shoqërisë.



Komandanti nënshkruan doktrinat për funksionimin e FSK-së



Prishtinë, 17 dhjetor 2019 - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në njëvjetorin e nënshkrimit të ligjeve të FSK-së, ka nënshkruar edhe doktrinat bazë, të cilat vendosin parimet konceptuale të funksionimit të FSK-së. Ceremonia e nënshkrimit të doktrinave u bë në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ku ishin të pranishëm: zv. komandanti i FSK-së, gjenerali Enver Cikaqi, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s, gjenerali Michael Obernayer si dhe oficerë të lartë të FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë aktit solemn nënshkroi këto doktrina: Doktrina e Përgjithshme Ushtarake e FSK-së; Doktrina e Inteligjencës; Doktrina e Përgjithshme e Operacioneve; Doktrina e Planifikimit dhe Doktrina e Komunikimit. Me këtë rast, gjenerali Rrahman Rama, tha se: Forca e Sigurisë së Kosovës po e përmbyll edhe një vit të suksesshëm me konsolidimin e bazës së saj nënligjore dhe doktrinare sipas mandatit të ri të FSK-së.



Sekretari i ushtrisë amerikane takoi zv. ministrin e MM-së dhe komandantin e FSK-së



Prishtinë, 2 qershor 2019 – Zv. ministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë takimit në Prishtinë, me sekretarin e Ushtrisë Amerikane, Dr. Mark Esper e falënderuan atë, për mbështetjen e vazhdueshme amerikane për sigurinë në Kosovë dhe rajon, duke vlerësuar lart kontributin e trupave ushtarake amerikane në shtetin tonë, si dhe biseduan për thellimin e partneritetit Kosovë-SHBA dhe formësimin e së ardhmes sonë të sigurt e të mbrojtur, për arritjen e objektivit tonë shtetëror e shoqëror drejt NATO-s, si dhe për gatishmërinë e Kosovës për të kontribuuar krah për krah me trupat amerikane dhe të NATO-s kudo nëpër botë. Dr. Mark Esper është sekretari i 23-të i ushtrisë amerikane, i cili në nëntor të vitit 2017 është konfirmuar nga Senati Amerikan. Si sekretar i ushtrisë amerikane, Dr. Esper, është përgjegjës për të gjitha çështjet që ndërlidhen me ushtrinë amerikane, përfshirë rekrutimin, organizimin, trajnimin, pajisjen dhe kujdesin për 1.4 milionë pjesëtarë aktivë, Gardën Kombëtare, ushtarët rezervë, Departamentin e Civilëve të Ushtrisë dhe familjet e tyre.

Ministria e Mbrojtjes e Kosovës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes të Turqisë

Prishtinë, 04 prill 2019 - Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, z. Rrustem Berisha priti në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, z. Hulusi Akar. Ministri i Turqisë, z. Hulusi Akar u prit me nderime të larta ushtarake nga Njësia Ceremoniale dhe Trupa Muzikore e FSK-së. Ministri i Turqisë shoqërohej nga një ekip i gjerë bashkëpunëtorësh dhe zyrtarësh, kurse ministri Berisha shoqërohej nga komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama dhe gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, si dhe zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes. Në takimin e përbashkët të dy delegacioneve u prezantuan arritjet e përgjithshme të FSK-së, procesi i transformimit dhe perspektiva e zhvillimit sipas planeve të parapara. Po ashtu u bë edhe prezantimi i bashkëpunimit të deritashëm ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Turqisë si dhe të dy ushtrive përkatëse, duke evidentuar mundësitë e thellimit të bashkëpunimit të mëtejmë edhe në të ardhmen. Në fund të takimit të dy ministrat, Berisha dhe Akar, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, në të cilën përfshihen fushat me interes të përbashkët.



Gjermania i ndan FSK-së një grant 500 mijë eurosh



Prishtinë, 19 shtator 2019 - Në Ministrinë e Mbrojtjes, z. Faruk Geci ushtrues i detyrës së sekretarit të përgjithshëm të MM-së dhe z. Christian Heldt, ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë nënshkruan marrëveshje, me anë të së cilës Qeveria gjermane ndan një grant me vlerë 500,000€ (pesëqind mijë euro) për FSK-në, për blerjen e materialeve dhe pajisjeve mjekësore. Me këtë rasat, sekretari Geci ka falënderuar ambasadorin Heldt dhe përmes tij Qeverinë dhe popullin gjerman për ndarjen e mjeteve financiare për shërbimin mjekësor të FSK-së, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme që Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë është duke dhënë për ndërtimin e kapaciteteve të FSK-së. FSK-ja me fondin e dhuruar nga Qeveria gjermane ka për qëllim të përmirësojë pajisjet e Qendrës Mjekësore të saj, si dhe synon të sigurojë materiale dhe pajisje mjekësore që do të ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve dhe shërbimeve mjekësore të FSK-së.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama u takua me zëvendësshefin e Shtabit të Ushtrisë Amerikane gjenerali James McConville

SHBA, 06 qershor 2019- Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama gjatë vizitës zyrtare në SHBA, u prit nga zv. shefi i Shtabit të Ushtrisë Amerikane, gjenerali James McConville, me të cilin biseduan për mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit në mes të FSK-së dhe Ushtrisë Amerikane. Gjeneral Rama, theksoi se FSK-ja është e gatshme të kalojë nga konsumues i sigurisë në ofrues të sigurisë. Në vazhdën e takimeve zyrtare gjenerali Rrahman Rama u takua edhe me znj Laura Cooper, zv. asistente e Sekretarit të Mbrojtjes për Rusi, Ukrainë dhe Euro Azi. Departamenti i Mbrojtjes dhe Stafi i Bashkuar vlerësuan lart punën dhe besueshmërinë e FSK-së, në kuadër të mbajtjes së frymës së diversitetit etnik dhe vazhdimin e implementimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit, me mundësi të zgjerimit të bashkëpunimit dypalësh për misionin e ri.



Ministri i Mbrojtjes pjesë e takimit „Karta e Adriatikut A-5"



Tiranë, 13 dhjetor 2019 –Në Tiranë është mbajtur Ministeriali i radhës i Nismës SHBA-Karta e Adriatikut. Në këtë takim mori pjesë edhe ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës z. Rrustem Berisha. Kosova e ka statusin e vendit vëzhgues në këtë Nismë, që përbëhet nga SHBA-ja, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia. Në fjalën e tij, ministri Berisha informoi pjesëmarrësit e takimit për disa nga zhvillimet dhe arritjet e FSK-së, pas miratimit të pakos së ligjeve për MM dhe FSK-në dhe fillimit të implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së. Ministri Berisha, shtoi se Republika e Kosovës është e përkushtuar për paqe, siguri, stabilitet dhe bashkëpunim me të gjithë, prandaj bashkëpunimi rajonal dhe fqinjësia e mirë janë gurë themeli për një Ballkan të qëndrueshëm dhe të sigurt. Duke iu referuar misionit të Nismës SHBA-Karta e Adriatikut, dhe politikës së dyerve të hapura, ministri Berisha përsëriti synimin e Republikës së Kosovës që ta ngritë nivelin e pjesëmarrjes në këtë Nismë, nga vend vëzhgues në vend anëtar, duke u zotuar se "ne jemi të përkushtuar që t'i pranojmë të gjitha përgjegjësitë e një anëtari të A5 dhe të marrim një rol aktiv në përpjekjet tona të përbashkëta". Ministrat e Mbrojtjes të shteteve anëtare të Nismës SHBA-Karta e Adriatikut, përmes deklaratës përfundimtare të takimit në Tiranë, u angazhuan të ndërtojnë kapacitete të përbashkëta ndaj fatkeqësive natyrore. Ministrat e vendeve të Kartës së Adriatikut, nxitur edhe nga pasojat që shkaktoi tërmeti i 26 nëntorit në Shqipëri, u shprehën se qëndrojnë pranë popullit shqiptar në këto çaste të vështira. Ministrat e A-5 gjithashtu ranë dakord të mbështesin anëtarësimin e të gjitha vendeve të Evropës Juglindore në strukturat Euro-Atlantike. Ministri Berisha, në margjinat e konferencës pati një sërë takimesh bilaterale me ministrat e mbrojtjes dhe kryesuesit te delegacioneve të Shqipërisë, Maqedonisë e Veriut, Malit të Zi dhe Kroacisë. Në këto takime u diskutua për avancimin e bashkëpunimit dypalësh me theks të veçantë në reflektimin e mandatit të ri ushtarak të FSK-së në aktivitetet e përbashkëta.

Ministri Berisha dhe gjenerali Rama takojnë komandantin Suprem të NATO-s

Më 19 korrik 2019 - Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama u takuan me gjeneralin Tod Wolters, komandant Suprem i Forcave Aleate për Evropë. Ministri Berisha dhe gjeneral Rama me gjeneralin Tod Wolters biseduan edhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në mes të NATO-s dhe FSK-së, për zhvillimin e një force profesionale me standarde të NATO-s. Nga ana e tij, komandanti Suprem i NATO-s, gjenerali Wolters, ndër të tjera, përsëriti zotimin e NATO-s dhe KFOR-it për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon.



FSK-JA PARAKALON NË 11-VJETORIN E

Prishtinë, 17 shkurt 2019 - Në përvjetorin e 11-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në sheshin „Skënderbeu" parakaluan kuadratet e Ushtrisë së Kosovës para udhëheqësve shtetërorë dhe mijëra qytetarëve. Ceremonia solemne e manifestimit filloi me intonimin e himnit të Kosovës nga Orkestra frymore e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Në manifestimin qendror që u mbajt me këtë rast ishin të pranishëm udhëheqësit shtetërorë të Kosovës; presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, kryeministri i Republikës Shqipërisë Edi Rama, ambasadori i SHBA-ve, Fhilip Kosnnet, vëllai i komandanti legjendar Adem Jashari, Rifat Jashari, ministra dhe mysafirë të shumtë, ambasadorë, diplomatë, përfaqësues të KFOR-it, si dhe mijëra qytetarë të Kosovës dhe trojeve etnike. Po ashtu ishin të pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes z. Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, zyrtarë të lartë të ministrisë, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, gjatë fjalimit të tij, në përvjetorin e 11-të të Pavarësisë, pos tjerash tha se FSK-ja është krenaria e Kosovës. „Para nesh kemi një ushtri profesionale, e cila është në shërbim dhe mbrojtje të shtetit më të ri në Evropë, e gatshme për të kontribuar për paqe në rajon dhe botë. Vendimi për themelimin e ushtrisë ishte i drejtë, legjitim dhe mesazh historik" tha veç tjerash presidenti Thaçi. Pas fjalës së presidentit, komandanti i parakalimit, gjenerali Enver Cikaqi, raportoi para presidentit Hashim Thaçi, për gatishmërinë e kuadrateve të FSK-së për parakalim. Kuadratet e FSK-së, gjatë parakalimit u shoqëruan me duartrokitje nga qytetarët e pranishëm në sheshin Skënderbeu.



Gjenerallejtënant Rrahman Rama në Konferencën e Shefave të Mbrojtjes në Gjermani

Wiesbaden-Gjermani, 25 tetor 2019 - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në Konferencën e 27-të vjetore të shefave të Mbrojtjes, e cila u mbajt në Wiesbaden të Gjermanisë, nga data 23 deri më 25 tetor 2019. Në konferencë morën pjesë mbi 37 shefa të Mbrojtjes të shteteve evropiane, anëtare të NATO-s dhe shtete partnere të Kosovës. Konferenca u organizua nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe kishte për tematikë „Gatishmërinë Strategjike", në kontekst të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së gatishmërisë kolektive bazuar në sfidat aktuale të sigurisë në botë. Po ashtu temë e kësaj konference ishte edhe ndërveprimi ndërmjet shteteve anëtare të NATO-s si dhe aftësia për t'u adaptuar ndaj sfidave të sigurisë. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama,



zhvilloi takime me shefin e Shtabit të Ushtrisë Amerikane gjeneralin James McConville dhe komandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjenerallejtënant Christopher Cavoli, si dhe me homologë të shumtë të shteteve mike. Komandanti i FSK-së, ndër të tjera në këtë konferencë ka thënë: „FSK-ja mbetet e përkushtuar në ndërtimin e aftësive të reja mbrojtëse sipas planit të tranzicionit, në mbështetje të plotë të partnerëve strategjikë, si dhe mbetet e përkushtuar në zhvillimin e kapaciteteve në të gjitha fushat me qëllim të ndërveprimit me partnerët strategjikë dhe me shtetet tjera partnere".

SHËNIMIT TË PAVARËSISË



FSK-ja nderon „Epopenë e UÇK-së"



Prishtinë, 5 mars 2019 - Në kazermën „Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, u mbajt manifestimi qendror në shënim të 21-vjetorit të „Epopesë së UÇK-së", në nderim dhe përkujtim të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Manifestimi për Epopenë e UÇK-së, u mbajt nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës z. Ramush Haradinaj. Pas revistës së kuadrateve të FSK-së nga presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së gjenerali Rrahman Rama u bë vendosja e luleve pranë Obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit presidenti Thaçi, pos tjerash tha: „Sot kujtojmë sakrificën e pashembullt të familjes Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Kjo sakrificë sublime, bëri kthesë të jashtëzakonshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Bota filloi ta kuptojë drejtë Kosovën. UÇK-ja u bë projekti më madhor kombëtar në historinë e kombit shqiptar. Këtë përvjetor për herë të parë Epopenë e UÇK-së, po e shënojmë me ushtrinë e Kosovës, të njohur edhe ndërkombëtarisht si forcë moderne, profesionale dhe shumetnike ka përfunduar fjalën e tij, presidenti Thaçi, duke shtuar se në të ardhmen e afërt Kosova do të bëhet pjesë e NATO-s, Bashkimit Evropian, OKB-së dhe do t'i forcojë raportet speciale me SHBA-të". Ndërsa, kryeministri Haradinaj, në fjalën e tij, tha: „Në marsin e 1998-së midis Evropës u shua një familje e tërë, por bota e lirë u zgjua dhe nuk lejoi të zhduket një popull, i cili, nga historia evropiane dhe botërore kishte mësuar ndër breza të jetojë i lirë, në vend të vetin, me nder dhe dinjitet dhe duke i respektuar të tjerët që jetojnë pranë tij. Heronjtë dhe dëshmorët e Kosovës, veçanërisht Jasharët dhe komandanti legjendar Adem Jashari, na kanë dhënë këtë leksion: Vetëm një popull që është i gatshëm ta mbrojë lirinë me çmimin e jetës, e ka të ardhmen e sigurt"! Kurse për themelimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë, kryeministri Haradinaj, shtoi: „Vota për Ministrinë e Mbrojtjes, për FSK-në dhe për shërbimin në këtë forcë, e lartësoi emrin e atdheut tha në fund kryeministri Haradinaj. Rifat Jashari, vëllai i komandantit Adem Jashari, duke uruar të gjithë, për formimin e ushtrisë së Kosovës, tha se; dëshiron që këta ushtarë të jenë të gatshëm gjithmonë të mbrojnë territorin e Kosovës, siç e ka mbrojtur Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Në fund, Trupa muzikore e FSK-së, ekzekutoi disa pika muzikore.



Mbahet konferenca „FSK dhe Partnerët 2019-1"



Prishtinë, 16 MAJ 2019 - Në Ministrinë e Mbrojtjes, për herë të parë pas miratimit të ligjeve për Ministrinë dhe FSK-në, u mbajt konferenca „FSK dhe Partnerët 2019-1. Ministri Berisha, duke iu drejtuar të gjithë atasheve ushtarakë dhe atyre të Mbrojtjes të shteteve të rajonit, shteteve partnere, shteteve të NATO-s, si dhe të gjithë të ftuarve të tjerë, tha: „Të gjitha të arriturat e FSK-së janë suksese të përbashkëta dhe kjo histori suksesi është e Kosovës dhe aleatëve perëndimorë. FSK-ja edhe me mandatin e ri do të jetë forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme, ku diversiteti është dhe do të mbetet vlerë, ku barazia është për të gjithë. Ne jemi të kënaqur me bashkëpunimin dhe bashkërendimin që kemi tash e 20 vjet me misionin e KFOR-it në Kosovë, të cilëve dua t'iu falënderohem për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon. Republika e Kosovës është e përkushtuar për paqe, siguri, stabilitet dhe bashkëpunim me të gjithë. Ne jemi të bindur se paqja e përhershme arrihet me anëtarësimin e secilit shtet të rajonit në NATO",- përfundoi fjalën e tij ministri Berisha. Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama në fjalën e tij, ndër të tjera tha: „Ne kemi avancuar dukshëm në ngritjen e kapaciteteve duke arritur ndërveprueshmëri me partnerët tanë. Këtë më së miri e kemi dëshmuar në ushtrimin fushor "Shqiponja 6", si dhe në pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrimet në nivel ndërkombëtar. FSK-ja ka nevojë për mbështetjen tuaj në rrugëtimin tonë të përbashkët për të qenë të gatshëm që t'ju mbështesim në të ardhmen atëherë kur të kërkohet. Ju partnerë të FSK-së, keni një rol të rëndësishëm në zhvillimin e FSK-së si forcë ushtarake e besueshme dhe gjithëpërfshirëse",- u shpreh gjeneral Rama. Gjatë seancës së parë folën edhe komandanti i KFORit, gjeneral majori Lorenzo D'Addario dhe drejtori i NALT-it gjeneral brigade Uwe Becker. Në punimet e konferencës „FSK dhe Partnerët- 1" morën pjesë ministri Berisha, zv. ministrat Ramadani dhe Çeku, gjenerali Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, komandanti i KFOR-it gjenerali Lorenzo D'Adario, drejtori i NALT-it, gjenerali Uwe Becker, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së, KFOR-it dhe NALTit, si dhe atashe të Mbrojtjes nga Shqipëria, SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar, Kroacia, Turqia, Maqedonia, Mali i Zi, Gjermania, Italia, Hungaria, përfaqësues të KFOR-it dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës i NATO-s për MM/FSK. Konferenca i vazhdoi punimet edhe në ditën e dytë, ku u prezantuan projektet e disa prej fushave me interes të veçantë për zhvillimin e Forcës në këtë fazë. Ndërsa, konferenca e dytë „FSK dhe Partnerët 2019-2"u mbajt më 26 nëntor 2019 në Ministri të Mbrojtjes.

Komandanti i KFOR-it gjenerali D'addario ligjëroi për kadetët e FSK-së

Prishtinë, 06 maj 2019 - Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Lorenzo D'addario, mbajti ligjëratë para kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së. Gjenerali D'addario gjatë ligjërimit shtjelloi disa tema të rëndësishme, ku kryesisht shpalosi përvojën e tij personale gjatë ngritjes në karrierë, sidomos përvojën e fituar gjatë misioneve dhe angazhimeve të tij në kuadër të NATO-s. Pas përfundimit të ligjëratës, kadetët patën mundësi të shtrojnë pyetje të ndryshme rreth temave që shtjelloi gjeneralmajor D`Addario. Në fund, kadetët e FSK-së bënë foto me komandantin e KFOR-it.



Shtohen radhët e FSK-së



Prishtine, 9 gusht 2019 - Në kazermën „Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, mbi 700 rekrutë (dy gjenerata) të rinj, solemnisht dhanë betimin për shërbim në FSK, pas përfundimit të trajnimit Bazik nëntë-javorë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Ministri Rrustem Berisha foli për rëndësinë e betimit të ushtarit për shërbim ndaj vendit: „Kjo është një datë me rëndësi për karrierën dhe jetën tuaj, për FSK-në, Ministrinë e Mbrojtjes dhe shtetin e Kosovës. Nuk ka detyrë më të ndershme se sa t'i shërbesh vendit dhe të kontribuosh në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend dhe më gjerë. Ju jeni gjenerata e parë e ushtarëve që keni nderin t'i bashkoheni FSK-së me mandat të ri ushtarak. Si ministër i Mbrojtjes, jam krenar me vajzat dhe djemtë tanë ushtarë, nënoficerë

KFOR-i dhe FSK-ja mbajnë ushtrimin e përbashkët „Shpata e Argjendtë 2019-02

Prishtinë, 30 shtator 2019 - Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me KFOR-in, Forca e Sigurisë së Kosovës, nga data 24 deri më 26 shtator 2019, ishte pjesë e ushtrimit në vendkomandë „Silver Sabre 2019-02". Këtë ushtrim KFOR-i dhe FSK-ja e zhvilluan përreth 56 orë pandërprerë në dy vendbazime: në kampin e KFOR-it në Film City dhe në Qendrën 112 të AME-së në Hajvali. Pjesë e realizimit të këtij ushtrimi ishin disa partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë: Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, Këshilli i Sigurisë Kombëtare, NALT-i, KFOR-i dhe EULEX-i. FSK-ja në këtë ushtrim të përbashkët mori pjesë me mbi 20 pjesëtarë, që nga faza fillestare e deri në ditën e ekzekutimit të këtij ushtrimi, me qëllim të demonstrimit të aftësive të veprimit në një mjedis shumëkombësh dhe të shkëmbimit të përvojave me institucionet tjera. Roli i pjesëtarëve të FSK-së në ushtrimin „Silver Sabre 2019-02", ishte zhvillimi i operacioneve të simuluara të kërkim-shpëtimit në ujëra, deminim, MKAB dhe xhenio.



me rekrutë të rijnë



dhe oficerë, të cilët me sukseset e tyre në shkollat dhe trajnimet e përfunduara në akademitë e ndryshme të vendeve të NATO-s, kanë treguar paraqitje të shkëlqyer dhe kanë përfaqësuar me nder FSK-në. Pres që edhe ju ta ndiqni shembullin e tyre"-shprehet ministri Berisha. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli ka uruar rekrutët e rinj të FSK-së, për sukseset e arritura, duke i falënderuar edhe partnerët strategjikë të Kosovës dhe NATO-s për mbështetjen e FSK-së. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama para ushtarëve të rreshtuar u shpreh: „Ky trajnim, i cili ka zgjatur 9 javë, ka vendosur themelet bazë për karrierën tuaj ushtarake. Ky profesion fisnik kërkon angazhim dhe përkushtim maksimal për t'i shërbyer vendit me nder dhe dinjitet. Prandaj, unë sot jam shumë i lumtur që ju jeni ata të cilët me angazhimin tuaj keni dëshmuar se FSK-ja, nga sot, në radhët e veta do t'i ketë djemtë dhe vajzat më të zotë të këtij vendi". Gjeneral Rama në fund pati edhe një këshillë për ushtarët e rinj; „Gjatë karrierës suaj, ju do të ballafaqoheni me sfida të ndryshme, andaj nga ju pritet që të jeni të disiplinuar, të përkushtuar dhe gjithmonë të përgatitur t'i kryeni detyrat sipas udhëzimeve të eprorëve tuaj". Në gjeneratën e parë betimin e dhanë 347 rekrutë, prej tyre 52 të gjinisë femërore dhe 22 pjesëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë. Ndërsa në gjeneratën e dytë, betimin e dhanë 337 rekrutë të rijnë; prej tyre 251 meshkuj, 47 femra dhe 38 pjesëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë.

AKREDITOHET QENDRA PËR STUDIME UNIVERSITARE E FORCËS SË SIGURISË TË KOSOVËS

Prishtinë, 17 tetor 2019 - Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve ka nxjerrë vendim me rastin e procesit të validimit dhe akreditimit të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë të Kosovës. KD i AKK-së, në vendimin e lëshuar, njofton se „validohet dhe akreditohet Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë të Kosovës, me adresë; Kazerma „Adem Jashari" në Prishtinë, për periudhën tri vjeçare 30.09.2019 deri më 30.09.2022 me kualifikimin: „Nëntoger në Forcat e Armatosura, Niveli V, sipas KKK me 120 kredi të AAP". FSK-ja në kuadër të mandatit të ri për ngritjen e kapaciteteve profesionale të edukimit ushtarak ka rishikuar dhe zhvilluar plan-programin e QSU-së, për fillimin e procesit të akreditimit bazuar në nenin 23, pika 6 e Ligjit nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, andaj si rezultat i një pune profesionale të KDS-së dhe QSU-së, është marr vendim mbi akreditimin e profesionit të ushtarakut nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Kjo nënkupton që kadetët që studiojnë në QSU, tashmë diplomohen në dy



programe të akredituara njëkohësisht, programi profesional „Nëntoger në Forcat e Armatosura" i akreditуar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe ai civil me titullin „Baçelor i Shkencave" i akreditуar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Këto dy diploma janë kriter bazë për emërimin si nëntoger në FSK, apo Forcat e Armatosura të vendeve tjera. Akreditimi i QSU-së si institucion edukativo-arsimor ushtarak dhe validimi i programit të saj, është një hap i rëndësishëm për të ardhmen e FSK-së. Ky proces do të ndikojë në masë të madhe që kadetët të aftësohen në mënyrë më të strukturuar dhe më cilësore. Ndërsa, në anën tjetër kjo kërkon nga stafi akademik që të jenë në hap me zhvillimet ushtarake dhe të përdorin teknikat më moderne të mësimdhënies. Vizioni i FSK-së është që në të ardhmen të avancojë edhe më tej QSU-në dhe të zhvillohet si institucion ushtarak rajonal, me vlera standarde dhe parime bashkëkohore për përgatitjen e gjeneratave të reja në ballafaqim me sfidat e së ardhmes.

Diplomojnë kadetët e FSK-së, gjenerata 2019



Ferizaj, 27 qershor 2019 - Në kazermën „Skënderbeu“ të FSK-së në Ferizaj, u mbajt ceremonia e diplomimit të tetë kadetëve të FSK-së dhe dy kadetëve të FA të Republikës së Shqipërisë, të shkolluar në QSU të FSK-së, të cilët u graduan me gradën e nëntogerit si dhe morën emërimet në detyrë për shërbim si oficerë të rinj në FSK-së, përkatësisht në ushtrinë shqiptare. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj tha: „Ju uroj për gradimin dhe ju falënderoj për shërbimin e deritashëm. Ju ftoj që të shërbeni me nder në ushtrinë e Kosovës, për popullin e Kosovës, për paqen dhe për rreshtin e ushtrive të paqes të cilit ne i takojmë dhe do t'i takojmë, pra së shpejti në NATO, të cilës i prin SHBA-ja". Ndërsa, ministri Berisha tha: „Sot duhet të jeni krenarë për arritjet tuaja dhe të zotoheni që ta nderoni uniformën e FSK-së, ta nderoni Atdheun dhe të mbroni paqen, lirinë dhe shtetin e ndërtuar me shumë sakrificë", tha ministri Berisha. Ju jeni pjesë e një Force profesionale, të besueshme, shumetnike që jemi duke e ndërtuar bashkë me aleatët tanë. Synimi ynë strategjik është anëtarësimi në NATO dhe unë jam i bindur se pa marrë parasysh sfidat gjeopolitike të çastit, me djemtë dhe vajzat si ju e ardhmja euroatlantike e Republikës së Kosovës është e sigurt. Kurse komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama tha: „Nuk ka vlerë më të madhe se kur ke oficerë të devotshëm, profesionalë dhe me vlera të larta njerëzore në radhët e organizatës. Ju kadetë që po diplomoni sot, ju siguroj që keni bërë gjënë më fisnike që mund ta bënit, të përgatiteni për katër vite rresht. Jeni përgatitur për të mbrojtur qytetarët dhe për të kontribuar për një botë më të mirë për fëmijët tanë dhe të ardhmen e këtij vendi. Oficerët e rinj që kanë diplomuar në Qendrën për Studime Universitare po na bëjnë krenarë çdo herë me shkollime, trajnime dhe gara të ndryshme jashtë vendit". Me medalje u nderua kadeti Dritëro Bajrami për rezultate të larta në përvetësimin e programit mësimor përgjatë katër viteve të studimeve, si dhe kapteri Naim Smakolli instruktor, u dekorua me „Medalje për shërbim vetëmohues“ për arritje të larta në planifikimin dhe zbatimin e plan-programit mësimor në QSU-së, gjatë vitit akademik 2018/2019.



Kadetët e FSK-së pjesë e ushtrimit ndërkombëtar „Kampi Veror 2019"



Maqedoni-Krivollak, 26 korrik 2019 - Me stërvitjen taktike në poligonin ushtarak në Krivollak të Maqedonisë së Veriut, kadetët e akademive ushtarake të 12 shteteve pjesëmarrës përfunduan me sukses ushtrimin fushor „Kampi Veror 2019". Në këtë ushtrim krahas kadetëve të SHBA-së, Shqipërisë, Gjermanisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës Çeke, Bullgarisë, Kroacisë, Malit të Zi, Norvegjisë, Maqedonisë së Veriut morën pjesë edhe kadetët e FSK-së, të cilët demonstruan me sukses aftësitë e tyre profesionale si dhe nivelin e gatishmërisë të fituara gjatë studimeve në QSU. Ditën kryesore të ushtrimit fushor „Kampi Veror 2019" ushtrimin e përcolli gjeneral brigade Irfete Spahiu, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe oficerë të lartët të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së. Kadetët e FSK-së edhe këtë vit u dalluan me paraqitjen e tyre të shkëlqyeshme, si në operacionet individuale ashtu edhe kolektive. Në përmbyllje të ushtrimit, gjeneral Spahiu, ka përgëzuar të gjithë kadetët e FSK-së, për pjesëmarrje në ushtrimin fushor si dhe për profesionalizmin, disiplinën dhe ndërveprimin e realizuar me kadetët e shteteve pjesëmarrëse. Ushtrimi fushor „Kampi Veror 2019" ka karakter ndërkombëtar dhe organizohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe Akademia Ushtarake e Maqedonisë së Veriut, në të cilin për çdo vit po marrin pjesë kadetët nga vende të rajonit e më gjerë, të menaxhuar nga instruktorë të NATO-s dhe të Partneritetit për Paqe.

Kadetët e FSK-së realizojnë ushtrimin fushor „Kampi i Avancuar 2019"



Mitrovicë, 18 qershor 2019 - Kadetët e Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, përfunduan me sukses ushtrimin fushor „Kampi i Avancuar 2019". Ushtrimi është realizuar nga data 06-18 qershor 2019, në fshatin Kovaçicë të Komunës së Mitrovicës, dhe ka përfshirë rajonin e Prishtinës, të Mitrovicës, të Vushtrrisë dhe të Podujevës. Në ditën e fundit të ushtrimit, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, shprehet: „Jam i vetëdijshëm që ky ushtrim ka qenë një sfidë për të gjithë e në veçanti për kadetët e vitit të parë, por nga gjithë kjo që pash, jam mjaft i kënaqur dhe krenar më të arriturat e QSU-së. Ju përgëzoj të gjithëve për një përmbyllje kaq të suksesshme të vitit. Më gëzon shumë fakti që në këtë akademi kemi edhe kolegë nga Shqipëria. Në të ardhmen synojmë që këtë akademi ta bëjmë Akademi Ndërkombëtare. Pra vazhdoni të punoni me angazhim, përkushtim dhe përgjegjësi sa më të lartë, pasi që e ardhmja e FSK-së jen ju". Qendra për Studime Universitare organizon ushtrime të tilla fushore çdo vit, me qëllim të vlerësimit të aftësive të kadetëve të QSU-së, në udhëheqjen, planifikimin dhe zbatimin e operacioneve luftarake.

Betohen kadetët e rinj të FSK-së




Prishtinë, 26 shtator 2019 - Në repartet e kazermës „Adem Jashari“ të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së në Prishtinë, u zhvillua ceremonia e betimit e kadetëve të rinj, gjenerata 2023, të cilët filluan vitin akademik 2019/20 në Qendrën për Studime Universitare të Akademisë së Mbrojtjes. Ministri Rrustem Berisha në fjalën e tij, tha: „Kjo është një datë me rëndësi për FSK-në. Ju jeni gjenerata e parë e kadetëve që keni nderin t'i bashkoheni FSK-së me mandat të ri ushtarak. Sot, duhet të jeni krenarë për arritjet tuaja dhe të zotoheni që gjithmonë do ta nderoni uniformën e FSK-së, ta nderoni atdheun, t'i respektoni eprorët tuaj dhe ta mbroni paqen, lirinë dhe shtetin tonë“. Në fund të fjalës së tij, ministri Berisha deklaroi: „Si ministër i Mbrojtjes, jam krenar me vajzat dhe djemtë tanë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, të cilët me sukseset e tyre në shkollat dhe trajnimet e përfunduara nëpër akademi të ndryshme të vendeve të NATO-s, kanë treguar paraqitje të shkëlqyer dhe kanë përfaqësuar me nder FSK-në, pres që edhe ju ta ndiqni shembullin e tyre“. Ndërsa, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu njoftoi për programin e edukimit dhe trajnimit të kadetëve. Në fund të ceremonisë, 14 rekrutët e rinj, para stafit komandues, solemnisht dhanë betimin si kadetë të FSK-së.

FSK-së i shtohen edhe dy pilotë të rinj



Turqi, 11 qershor 2019 - Ushtrisë së Kosovës po i shtohen radhët me kuadro të reja oficerësh, profilesh të ndryshme, për të qenë forcë profesionale dhe e ndërveprueshme me ushtritë tjera mbi bazën e standardeve të NATO-s. Në vazhdën e sukseseve të arsimimit dhe profesionalizimit janë edhe dy oficerë të rinj, pilotët e Ushtrisë së Kosovës, nëntogerët Atdhe Hasani dhe Krenar Voca, të cilët përfunduan me rezultate të shkëlqyera shkollimin profesional për pilot helikopteri në Akademinë Ushtarake "Kara Havacilik Okulu" në Republikën e Turqisë. Nëntoger Atdhe Hasani, me suksesin e treguar gjatë shkollimit të tij, ka arritur që të radhitet i dyti në mesin e kadetëve më të mirë të gjeneratës. Oficerët e rinj, do kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve ushtarake në lëmin e aviacionit të FSK-së. Republika e Turqisë në bazë të marrëveshjes dypalëshe, po vazhdon të ndihmojë në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja të FSK-së.



Komandanti i FSK-së dekoroi me „Medalje për Shërbim Vetëmohues" komandantin e Gardës së Ajovës



Prishtinë, 8 MAJ 2019 - Nën patronatin e kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Ministrinë e Mbrojtjes u organizua një pritje shtetërore për nder të komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majorit Timothy Orr, ku morën pjesë përfaqësues institucionalë, deputetë, ministra, përfaqësues diplomatikë të akreditуar në Kosovë dhe ushtarakë. Me këtë rast, komandanti i FSK-së gjenerali Rrahman Rama foli për rëndësinë e partneritetit ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, si dhe kontributin e gjeneralit Orr në këtë bashkëpunim. „Që nga themelimi i Programit të Partneritetit Shtetëror në vitin 2011, në saje të vizionit strategjik dhe përkushtimit strategjik të gjeneralit Orr, FSK-ja është zhvilluar si forcë më profesionale dhe e gatshme për t'ju shërbyer qytetarëve të saj. Gjeneral Orr, unë jam shumë mirënjohës për përpjekjet e jashtëzakonshme të ushtarëve të aviacionit të Garda Kombëtare të Ajovës, që kanë bërë, nën udhëheqjen tuaj, për zhvillimin e zyrtarëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së. Sot ne jemi më të fortë dhe më profesionalë, faleminderit Gjeneral".

Në fund, gjeneral Rama e dekoroi gjeneralin amerikan Timothy Orr me Medaljen për Shërbim Vetëmohues. Ndërsa, gjenerali Orr i entuziazmuar nga atmosfera e ngrohtë, e krijuar për nderë të tij, deklaroi: „Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe jam shumë krenar që po nderohem me medalje nga FSK-ja. Ne, në veçanti kemi zgjedhur Kosovën nga 18 vende. Nga këtu po shoh anëtarët e forcave të mia dhe të FSK-së. E keni përkushtimin tim dhe do të vazhdojmë të ju ndihmojmë në këtë fushë", tha ai.





Kolonel Sefer Isufi diplomohet në Institutin Shumëkombësh të Udhëheqjes Strategjike në Stamboll



Turqi-Stamboll, 21 shkurt 2019 - Koloneli Sefer Isufi ka diplomuar në Universitetin e Mbrojtjes në Stamboll, gjegjësisht në Institutin Shumëkombësh të Udhëheqjes Strategjike të Forcave të Përbashkëta, në degën e Komandimit dhe Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura në Operacione të Përbashkëta. Ai tregon se plan-programi studimor, ka përfshirë në mënyrë kronologjike modulet rreth sigurisë kombëtare , rajonale dhe globale, ndërlidhjen e tyre me strategjitë kombëtare të mbrojtjes dhe ushtarake, si dhe procesin e implementimit të tyre në operacione të mundshme të të gjitha komponentëve të forcave nga niveli i komandimit dhe drejtimit strategjik ushtarak. Ai kreu shkollimin për udhëheqje shtabore dhe komanduese në nivelin taktik dhe operacional ushtarak dhe mbrojti temën e masterit në artin e menaxhimit strategjik të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, kolonel Isufi, në të njëjtin universitet, diplomoi me sukses të lartë në nivelin e vlerësimit „Ekselent". Ai u dallua në mesin e pjesëmarrësve të rreth 20 ushtrive të vendeve nga tri kontinente.

Në Kolegjin e Luftës në SHBA diplomon nënkolonel Ejup Maqedonci

SHBA, 25 korrik 2019 – Gjatë studimeve në SHBA, nënkoloneli i FSK-së, Ejup Maqedonci, përpos përfundimit të programit të Kolegjit të Luftës, ka kryer edhe programin Master të Studimeve Strategjike dhe ka marrë Diplomën e Kolegjit dhe Diplomën e Masterit të Studimeve Strategjike. Kolegji i Luftës është institucion edukativ i Ushtrisë Amerikane në Pensilvani që përgatitë oficerët e lartë ushtarakë dhe zyrtarët e tjerë të institucioneve



të sigurisë për marrjen e përgjegjësive të lidershipit në nivel strategjik në institucione ushtarake dhe të sigurisë. Nga Kolegji i Luftës, bazuar në rezultatet dhe paraqitjen e treguar, nënkolonel Maqedonci ka marrë titullin „Student Superior", i cili nënkupton klasifikimin e tij, studenti më i mirë i vitit akademik 2019, në mesin 280 studentëve amerikanë dhe 76 oficerëve ndërkombëtarë pjesëmarrës nga 74 vende të ndryshme të botës.

Tre rreshtermajorë të FSK-së diplomohen në Akademinë e Rreshter Majorëve në SHBA



SHBA, 26 qershor 2919 - Korit të nënoficerëve të FSK-së iu shtuan edhe tre rreshtermajorë të diplomuar në Akademinë e Rreshter Majorëve në El Paso, Texas të SHBA-ve. Rreshtermajorët: Shukri Abdullahu, Blerim Ramusholli dhe Fatmir Rama, përfunduan me sukses Kursin për rreshter major, i cili njëherësh tregon për përsosmërinë e zhvillimit të NOF (Rreshter Majorit) si në ushtrinë amerikane ashtu edhe në FSK. Përgjatë një viti studimesh, kërkimesh dhe shkëmbimi përvojash, të tre rreshter majorët kaluan nëpër gjashtë departamente të ndryshme, ku pa mëdyshje nuk mungoi suksesi i tyre. Rreshter majorët e FSK-së, Abdullahu, Ramusholli dhe Rama, gjatë shkollimit dhe trajnimit në Akademinë e Rreshterë Majorëve në SHBA, e cila njihet si akademia më prestigjioze për përgatitjen e NOF-ve, u dalluan për gatishmëri, profesionalizëm dhe vlera të larta ushtarake.

Nëntogeri i FSK-së Petrit Loxha u diplomua për mjete eksplozive në SHBA




Prishtinë, 17 janar 2019 - Petrit Loxha, oficer i FSK-së, që nga muaji korrik i vitit 2018 e deri më 16 janar 2019, ka ndjekur trajnimin mjaft sfidues që ofron Ushtria Amerikane për mjete eksplozive në shkollën e Marinës, në Bazën Ajrore Eglin në Florida të SHBA-ve. Nëntogeri Logja, gjatë shkollimit, kaloi nëpër dy faza; Në fazën e parë u aftësua lidhur me çminimin, mjetet dhe metodat, databazën e mjeteve etj., ndërsa në fazën e dytë me mjetet tokësore, mjetet ajrore, mjetet e improvizuara, mjetet kimike dhe biologjike. Përgatitja e nëntogerit Loxha, në këtë fushë do t`i ndihmojë shumë Kompanisë së Deminimit të FSK-së në ngritjen e kapaciteteve të saja në fusha të caktuara dhe në përgatitjen e doktrinave me standardet e NATO-s. Nëntogeri Petrit Loxha gjatë shkollimit/trajnimit në SHBA, u dallua me paraqitje të shkëlqyer si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.

Togeri Xhevahir Hasanaj dekorohet nga ushtria e SHBA-së



SHBA, 18 nëntor 2019 - Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, togeri Xhevahir Hasanaj, përfundoi me suksese të lartë trajnimin „Civil Affairs“ që realizohet nga Qendra dhe Shkolla për Luftëra Speciale (Special Warfare Center and School) „John F. Kennnedy“ e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Toger Hasanaj ka treguar paraqitje të shkëlqyer në të gjitha fazat e shkollimit, duke u renditur si njëri nga studentët me vlerësimet më të larta. Si rezultat i paraqitjes së lartë; pas përfundimit të trajnimit, togeri Hasanaj u dekorua me medaljen e meritave „Commendation Medal“ dhe mori çmimin „Distinguished Honor Graduate“. Arritjet e shkëlqyeshme gjatë shkollimit për togerin e FSK-së, janë në vazhdën e sukseseve të tjera, si fitimi i çmimit „Kadeti më i mirë i huaj në fushën ushtarake, akademike dhe praktike“ në vitin 2017, gjatë shkollimit në Akademinë Mbretërore Sandhurst të Mbretërisë së Bashkuar.

Tetari Arian Zabeli dekorohet me çmimin „Gung Ho Award“



SHBA, 19 nëntor 2019 – Nënoficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, tetari Arjan Zabeli, përfundoi me sukses të lartë trajnimin „Advanced Infantry Marine Course“ në Bazën e Marinës të ushtrisë amerikane në SHBA. Gjatë shkollimit, në Bazën e Marinës Amerikane në SHBA, tetar Zabeli në të gjitha fazat e trajnimit ka treguar paraqitje të shkëlqyer, duke u renditur si njëri nga studentët me vlerësimet më të larta. Për paraqitje të shkëlqyeshme dhe arritje të rezultateve të veçanta gjatë trajnimit për udhëheqje (lidership) në SHBA, tetari Zabeli nderohet me çmimin „Gung Ho Award“. Sukseset e pjesëtarëve të FSK-së, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, janë treguesit më të mirë për progresin të cilin po e arrin FSK-ja në krijimin dhe avancimin e kapaciteteve të përgjithshme.

FSK-JA SHËNOI DITËN E FORC

FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS SHENOI DITËN E FORCËS, 27 NËNTORIN, ME EMBLEMA, FLAMUJ DHE GRADA TË REJA

Prishtinë, 27 nëntor 2019 - Në kazermën „Adem Jashari" të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, në Prishtinë, sot me ceremoni ushtarake u shënua 27 Nëntori-Dita e Forcës. Njësitet e FSK-së, parakaluan me emblema, flamuj dhe grada të reja. Ceremonia për shënimin e një vjetorit të themelimit të ushtrisë së Kosovës, filloi me inspektimin e kuadrateve të rreshtuara të FSK-së, nga presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Me këtë rast, presidenti Thaçi, në fjalën e tij, drejtuar oficerëve dhe nënoficerëve të Ushtrisë së Kosovës, tha: „Ushtria e Kosovës gëzon besim nga të gjithë qytetaret, është bërë institucioni që kontribuon për paqe dhe stabilitet në Kosovë. Kudo që kanë qenë pjesëtaret e FSK-së, së fundi edhe në garat ndërkombëtare me prestigjioze të mbajtura në Britaninë e Madhe, kanë shkëlqyer në këto gara. FSK-ja është fuqia dhe garancia më e mirë e sigurisë dhe stabilitetit të Kosovës", tha në fund presidenti Thaçi. Ndërsa, kryeministri Ramush Haradinaj, pos tjerash tha se: „Jam krenar sot që ushtria jonë është vlerë e sigurisë në rajon e në botë. Jam i lumtur që ky rresht i yti i paqes, nderojnë Kosovën dhe aleatët e lirisë". Kurse, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, tha: „Është nder i veçantë por njëkohësisht edhe privilegj për mua, t'u drejtohem sot në cilësinë e komandantit të FSK-së me rastin e Ditës më të rëndësishme - Ditës së Forcës. Prandaj me krenari iu njoftoj se FSK-ja brenda kësaj periudhe ka arritur që të realizoj themelimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe kapacitetet themelore të Gardës Kombëtare, Komandën e Logjistikës, Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe të njësive pranshtabore. Krahas këtyre, FSK-ja ka realizuar me sukses planin vjetor të rekrutimit duke rekrutuar rreth 700 ushtarë të rinj, duke ngritur përqindjen e përfaqësimit të komuniteteve në mbi 10% e sidomos atë të komunitetit serb, si dhe duke ngritur përqindjen e gjinisë femërore në mbi 11%. Ditën e Forcës sonë si gjithherë e kremtojmë bashkë me partnerët tanë në nivelin bilateral, me Ekipin Këshillëdhënës të NATO-s dhe me KFOR-in që gjithmonë ishin dhe janë me ne gjatë tërë rrugëtimit tonë. Ky partneritet do të vazhdojë e thellohet edhe më tej sepse është aspiratë e jona që edhe zyrtarisht të integrohemi në familjen e përbashkët të Aleancës Veri Atlantike". Gjeneral Rama tha se „FSK-ja është e përgatitur dhe e gatshme për pjesëmarrje dhe efektive në



operacione humanitare e dëshmoi edhe dje, pas tërmetit në disa vendbanime në Shqipëri, ku kontingjenti i Task-Forcës sonë. Në fund, komandanti i FSK-së, duke iu drejtuar ushtarëve dhe oficerëve të FSK-së, tha: „Sot ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FSK-së janë më të përgatitur, më të trajnuar e arsimuar dhe më të pajisur, por megjithatë jam i ndërgjegjshëm se ende mbetet për t'u bërë. Forcat tona po zhvillohen më tej, me vizion të qartë bazuar në koncepte bashkëkohore dhe profesioniste, në programe dhe planifikim afatgjatë me synimin që të realizojmë procesin e tranzicionit krahas zhvillimit e modernizimit të mëtejmë. Urime Dita e Forcës dhe na priftë e mbara në rrugëtimin drejtë qëllimit tonë të përbashkët", uroi në fund komandanti i FSK-së, gjeneral Rama.

GJENERALI AMERIKAN MARK MILLEI I URON KOMANDANTIT TË FSK-SË DITËN E FORCËS

SHBA, 27 nëntor 2019 - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka marrë letër urimi nga kryetari i Shefave të Stafeve të Përbashkëta të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjenerali Mark Millei. Në letër urimi shkruan: „Urime për Ju, burra dhe gra të Forcës së Sigurisë të Kosovës, me rastin e festës së Ditës së Forcës të Sigurisë së Kosovës. Në këtë përvjetor të rëndësishëm, unë vlerësoj lart përkushtimin tuaj në kryerjen operacioneve në përgjigje ndaj krizave dhe operacioneve për mbrojtje civile në Kosovë. Puna juaj për të krijuar një Forcë të integruar është demonstruar në iniciativat dhe reformat sociale të lidershipit të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Ushtria e SHBA-së vlerëson përkushtimin e lidershipit tuaj dhe partneritetin tonë me Forcën e Sigurisë



së Kosovës. Urimet më të mira për këtë rast të veçantë." Përfundon urimin e tij, kryetari i Shefave të Stafeve të Përbashkëta të Ushtrisë së SHBA-ve, gjenerali Mark Milley

ËS ME CEREMONI USHTARAKE



Ekspertët amerikanë së bashku me ekspertët e FSK-së demolojnë mjete të pashpërthyera



Prishtinë, 01 shkurt 2019 - Specialistë të Ekipeve për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera Eksplozive të Kompanisë së Deminimit të FSK-së, në bashkëpunim me specialistët e Ekipit të EOD-së, nga kampi amerikan „Bondsteel", kanë realizuar një operacion të përbashkët për shkatërrimin e mjeteve eksplozive të cilat janë gjetur nga ekipet e EOD-së, në rajone të ndryshme të Kosovës. Në këtë operacion janë demoluar 16 mjete të kalibrave të ndryshëm të cilat kanë qenë rrezik permanent për jetën e qytetarëve. Demolimet janë realizuar në fshatin Halilaq, të organizuar në dy cikle. Operacioni i demolimit ka shkuar sipas planifikimit dhe është realizuar me sukses. Për të përcjellë nga afër këtë operacion, prezent ishte edhe komandanti i kampit „Bondsteel", koloneli Macaraeg, koordinatori për Deminim nga „Film City", A. Cipri, zv. komandanti i RMC-së, nënkolonel Bajram Bekteshi, si dhe komandanti i Kompanisë së Deminimit major Gëzim Sada. Të pranishmit vlerësuan lartë bashkëpunimin e ekspertëve të EOD-së të FSK-së dhe KFOR-it.

Kompania e Materieve të Rrezikshme realizon operacionin për zhvendosjen dhe deponimin e materieve të rrezikshme

Prishtinë, 22 nëntor 2019 - Kompania e Materieve të Rrezikshme e Regjimentit të Mbrojtjes Civile e Gardës Kombëtare, gjatë këtij muaji ka zhvilluar dy operacione të rëndësishme për zhvendosjen dhe deponimin e materieve të rrezikshme. Në periudhën prej 14 deri më 20 nëntor 2019, një skuadër e Kompanisë së Materieve të Rrezikshme, ka zhvilluar operacionin e zhvendosjes dhe deponimit të materieve të rrezikshme (mbetje si reagenca që janë përdorur në zhvillimin e analizave laboratorike) nga Reparti i Biokimisë në QKUK-së, për në sanatorium (lokacionin brenda QKUK-së). Ky operacion ka përfunduar me mjaft sukses. Ndërkaq, nga data 11 nëntor 2019, zhvilluan operacionin për ri-ambalazhimin dhe deponimin e materieve të rrezikshme në „Devolli Corporation", ish-fabrika e tekstilit „Emin Duraku" në Gjakovë. Ky ri-ambalazhim dhe deponim ka rrjedhur si rezultat i inspektimeve të vazhdueshme nga Kompania e Materieve të Rrezikshme, me qëllim të reduktimit të rrezikut nga kontaminimi i mëtutjeshëm. FSK-ja është forcë profesionale e përgatitur mirë dhe e gatshme që t'iu përgjigjet të gjitha sfidave të sigurisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës me të gjitha kapacitetet e saj.



Komandanti i FSK-së nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Norwichit-SHBA



SHBA, 21 tetor 2019 - Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, më 17 tetor 2019, në kuadër të vizitës zyrtare në SHBA, ka nënshkruar marrëveshje me Universitetin e Norwich-it, për bashkëpunim në fushën e edukimit dhe hulumtimit shkencor në fushën ushtarake. Gjeneral Rama e falënderoi presidentin e Universitetit të Norwich-it, Richard Schneider për besimin dhe mundësinë e dhënë, duke theksuar se ky bashkëpunim do të kontribuojë në avancimin e njohurive dhe përvojave të kadetëve të të dyja institucioneve. Komandanti i FSK-së, së bashku me delegacionin vizitoi edhe Qendrën Trajnuese për Mbrojtje Kibernetike. Kolegji Ushtarak i Vermontit, me një traditë 200-vjeçare, konsiderohet të jetë institucioni ushtarak më i vjetër në SHBA, në të cilin edukohen dhe përgatiten kadetët e rijnë për të qenë liderë të ushtrisë amerikane. Realizimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi pritet të filloj në vitin 2020.

Komandanti i FSK-së merr pjesë në konferencën e 23-të të shefave të mbrojtjes



Durrës, 26 shtator 2019 - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA të Republikës së Shqipërisë, gjeneralit Bardhyl Kollçaku, mori pjesë në konferencën e shefave të mbrojtjes „Karta e Adriatikut A5", e cila u mbajte në Durrës. Gjeneral Rama, në këtë konferencë, udhëtoi nga Kosova së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralin Benjamin Corell. Konferenca u mbajt nga data 24-26 shtator 2019, e cila kishte për qëllim që të sinkronizojë të gjitha aktivitetet trajnuese por edhe ushtrimet e përbashkëta ndërmjet shteteve anëtare, përfshirë dhe EUCOM-in, në ngritjen e gatishmërisë dhe përmirësimin e ndërveprimin gjatë operacioneve të përbashkëta për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon si dhe mbështetja e shteteve që aspirojnë integrimin në NATO. Gjenerali Rrahman Rama i njoftoi pjesëmarrësit për procesin e tranzicionit, si dhe të arriturat e FSK-së. FSK-ja si forcë e ndërtuar dhe e zhvilluar me standarde të NATO-s, është e gatshme që t'i marrë përsipër të gjitha obligimet që dalin nga anëtarësimi në „Kartën e Adriatikut-A5", për të ndërvepruar dhe kontribuar me kapacitetet e saj për paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë". Gjeneral Rama, gjatë konferencës ka zhvilluar takime dypalëshe me zv. komandantin e EUCOM-it, gjenerallejtënant Stephen Twitty, si dhe me kryesuesit e delegacioneve të vendeve pjesëmarrëse në konferencë. Temë diskutimi gjatë këtyre takimeve ka qenë avancimi i bashkëpunimit në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të FSK-së, aktivitetet e përbashkëta trajnuese, por gjithashtu edhe ofrimi i kapaciteteve trajnuese të FSK-së, për zhvillim profesional të kapaciteteve të partnerëve tanë.

FSK-JA PËRFUNDON ME SUKSES OPERACIONIN E



Pas marrjes së urdhrit nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kontingjenti i Task-Forcës së Gardës Kombëtare të FSK-së për kërkim-shpëtim urban, i pajisur me mjetet teknike të specializuara udhëtoi për në Shqipëri, për t'iu dalë në ndihmë autoriteteve dhe banorëve shqiptarë, me qëllim të përballimit të situatës së krijuar pas goditjes së tërmetit të 26 nëntorit 2019. Kontingjenti i FSK-së, përbëhej nga 3 ekipe të kërkim–shpëtimit urban, një ekip K-9-tës (njësi e qeneve) për situata të tilla, ekipi i komunikimit, ekipi i policisë ushtarake dhe ekipi i mjekësisë. Njësitet e kërkim-shpëtimit me të arritur në zonën e goditur nga tërmeti, janë përfshirë në operacionet e shpëtimit në Durrës dhe Thumanë, dhe falë

Presidenti Thaçi dhe gjeneral Rama vizitojnë zonat e goditura nga tërmeti në Shqipëri

Durrës, 27 nëntor 2019 - Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama ka shoqëruar presidentin e Kosovës z. Hashim Thaçi në vizitë zonave të goditura nga tërmeti në Durrës. Qëllimi i kësaj vizite ishte që të njihen nga afër me punën dhe angazhimin e njësiteve të FSK-së, si dhe për t'i inkurajuar ushtarët në misionin e tyre humanitar në ndihmë të banorëve të goditur nga kjo fatkeqësi natyrore. Kjo vizitë ka për qëllim të shpreh solidaritetin në bashkëdhimbjen me qytetarët që kanë humbur më të dashurit e tyre dhe me të gjithë ata që kanë pësuar dëme nga ky tërmet. Presidenti Thaçi dhe gjeneral Rama deklaruan: „Ushtarët tanë janë duke u munduar të bëjnë më të mirën, atë që është e mundur dhe për këtë keni dëgjuar edhe vlerësimet e institucioneve vendore si dhe të qytetarëve që i kanë bërë për njësitë tona këtu. Për profesionalizimin e treguar, përkushtimin, angazhimin dhe sakrificën që po bëjnë këto ditë në ndihmë vëllezërve tanë. Ata i përgëzuan të gjithë ushtarët pjesë e këtij operacioni për punën dhe angazhimin e tyre profesional në Thumanë dhe Durrës.



Ministri Berisha vizitoi zonat e goditura nga tërmeti në Shqipëri



Ministri Rrustem Berisha ka vizituar zonat e goditura nga tërmeti në Shqipëri, ku ka takuar edhe ushtarakët e FSK-së, të cilët që nga momentet e para pas tërmetit tragjik që goditi Shqipërinë, me shumë profesionalizëm e përkushtim morën pjesë në operacionet e kërkim-shpëtimit. „Sot vizituam zonat e goditura nga tërmeti në Shqipëri. Është e papërshkrueshme dashuria dhe mirënjohja e thellë e qytetarëve të Durrësit dhe Thumanës për trupat e FSK-së që morën pjesë në operacionet e kërkim-shpëtimit gjatë këtyre ditëve. Banorët treguan për shumë raste trimërie kur ushtarët e Kosovës kanë rrezikuar jetën e tyre duke hyrë në objekte të rrënuara dhe gjysmë rrënuara për të shpëtuar jetët të tjera" ka thënë ministri Berisha.

KËRKIM-SHPËTIMIT PAS TËRMETIT NË SHQIPËRI

profesionalizimit dhe pajisjeve teknike të duhura, menjëherë kanë ndihmuar qytetarët në nxjerrjen dhe evakuimin e tyre nga gërmadhat. Njësitë e Gardës Kombëtare me sukses kanë përfunduar operacionet në mbështetje të autoriteteve të Shqipërisë, në menaxhimin e situatës së krijuar pas tërmetit në Shqipëri. Për përkushtimin dhe angazhimin profesional të treguar në Thumanë dhe Durrës njësitet e FSK-së kanë marrë mirënjohje dhe lëvdata nga të gjithë liderët shtetërorë si, presidenti, kryeministri, ministrja e Mbrojtjes, shefi i Shtabit, ushtarakë dhe qytetarë të shumtë të Shqipërisë. Pas përfundimit të operacionit, më 30 nëntor 2019, me urdhër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kontingjenti kthehet në Kosovë.



PRESIDENTI I SHQIPËRISË DEKORON NJËSITET E KËRKIM-SHPËTIMIT TË FSK-së



Prishtinë, 04 dhjetor 2019 - Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ilir Meta, ka dekoruar njësitin e kërkim-shpëtimit të FSK-së, për kontributin e dhënë; në shpëtimin e njerëzve, pas tërmetit të 26 nëntorit në Shqipëri. Presidenti Meta u prit nga komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralë, oficerë, nënoficerë të FSK-së. Zoti Meta ka falënderuar FSK-në, për reagimin e shpejtë për t'iu ardhur në ndihmë qytetarëve të prekur nga tërmeti i 26 nëntorit në Durrës dhe Thumanë. „Të dashur shpëtimtarë të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Policisë të cilët u paraqitën në orët e para të një beteje midis jetës dhe vdekjes, nuk ka vlerësim më të mirë se sa t'ju quaj shpëtimtarë të gjithë juve"- ka thënë presidenti Meta. Ai u shpreh se Kosova duhet të jetë krenare për Forcat e Sigurisë, për të shtuar se çdo vend i NATO-s, do të ishte i kënaqur me atë që ka shfaqur FSK-ja gjatë ditëve të kërkim-shpëtimit në Shqipëri, pas tërmetit të fuqishëm që goditi vendin. Presidenti Meta, shprehu konsideratë edhe për qenin hero të FSK-së, i cili shpëtoi jetë pas tërmetit. Presidenti Ilir Meta, ka ndarë "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" për Task-Forcën e FSK-së dhe "Dekoratën për Merita të Veçanta" për njësitin K-9 të FSK-së.

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË DEKORON ME „MEDALJEN E ARTË" TASK FORCËN E FSK-së

Prishtinë, 2019 - Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, i ka ndarë „Medaljen e Artë për Vlerësim Profesional" njësiteve të Kërkim-Shpëtimit të Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë të Kosovës, të cilat kanë qenë të angazhuara në kërkim-shpëtim, pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 që goditi Shqipërinë. "Medaljen e Artë" të dedikuar nga kryeministri i Shqipërisë e pranoi komandanti i FSK-së, nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Shqipëri Nait Hasani. Në certifikatën shoqëruese të



nënshkruar nga kryeministri Edi Rama; thuhet: „Medalje për Vlerësim Profesional i akordoi Task Forcës së kombinuar të Forcës së Sigurisë së Kosovës, me motivacionin: Për përkushtimin e jashtëzakonshëm në kërkimin dhe shpëtimin e jetëve të të prekurve nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 si dhe për vetëmohimin e treguar nga secili prej pjesëtarëve të njësisë për t'u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë, në kushte profesionale dhe njerëzore ekstreme".

Komandanti i ri i Gardës Kombëtare të Ajovës gjenerali Benjamin Corell vizitoi FSK-në

Prishtinë, 23 shtator 2019 - Zv. ministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, pritën komandantin e ri të Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajorin Benjamin Corell. Në takim u bisedua për partneritetin e suksesshëm dhe konkret ndërmjet MM/FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës në kuadër të partneritetit shtetërorë ndërmjet Kosovës dhe Ajovës. Në takimin e parë zyrtar në MM ndërmjet komandantit të FSK-së gjeneralit Rama dhe komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralit Corell u bisedua për




marrëdhëniet e shkëlqyera të FSK-së me GK të Ajovës, si dhe për gatishmërinë e dy institucioneve për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

Nënkolonel Ali Krasniqi emërohet atashe i Mbrojtjes në Republikën e Francës



Prishtinë, 28 mars 2019 - Falë bashkëpunimit të shkëlqyer që ka Kosova me Francën, përkatësisht Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës me Ministrinë e Armatave të Francës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës me Ushtrinë e Francës, më 28 mars 2019 u akreditua atasheu i parë ushtarak në Republikën e Francës. Më 18 prill 2019, nënkoloneli Ali Krasniqi, u prit në takim në Ministrinë e Armatave në Zyrën Ndërlidhëse me Misionet e Huaja pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Strategji nga koloneli Cyrille Barbie de Preaudeau, zv. shef i Zyrës Ndërlidhëse me Misionet e Huaja, i cili, ndër të tjera, e ka pajisur atasheun e FSK-së me një broshurë/guidë për atashetë e mbrojtjes.

Kapiteni Ismajl Hoxha përzgjidhet instruktor në Akademinë Ushtarake Mbretërore „Sandhurst''



Prishtinë, 19 mars 2019 - Bazuar në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, FSK-ja do të dërgojë kapiten Ismail Hoxhën instruktor në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst". Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama ia dorëzoi flamurin e Kosovës kapitenit Hoxha, i cili me angazhimin e tij, si instruktor do ta përfaqësojë në mënyrë të denjë vendin tonë në Akademinë Ushtarake Mbretërore „Sandhurst". Procesi i përzgjedhjes së oficerëve për të qenë instruktorë në këtë akademi është tejet rigoroz, prandaj FSK-ja po dëshmon se në strukturat e saj ka kuadro të përgatitur dhe të trajnuar sipas standardeve të NATO-s, dhe të aftë për të dhënë kontribut në ngritjen e kapaciteteve edhe në akademitë ushtarake me renome botërore. Angazhimi i kapitenit Hoxha, padyshim se do të kontribuojë në ngritjen e imazhit të FSK-së, jo vetëm në Mbretërinë e Bashkuar por edhe në mbarë botën. Kapiten Hoxha, në këtë akademi, do të jetë i angazhuar për dy vite rresht, për të vazhduar më pas kontributin e tij në ngritjen e kapaciteteve trajnuese të FSK-së sipas mandatit të ri. Kontributi i Mbretërisë së Bashkuar që nga vitit 2009 është i pazëvendësueshëm për zhvillimin dhe edukimin profesional të oficerëve të FSK-së,- ka thënë gjenerali Rrahman Rama.

Ministria e Mbrojtjes e Kosovës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes të Turqisë

Ankara, 18 dhjetor 2019 - Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes i Republikës së Kosovës z. Faruk Geci dhe kryetari i Presidencës i Industrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, prof. Ismail Demir, më 16 dhjetor 2019 në Ankara të Turqisë, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Presidencës së Industrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë. Kjo marrëveshje parasheh vazhdimin dhe thellimin e mëtejmë të raporteve sipas përmbajtjes së marrëveshjes së mëparshme të nënshkruar më 27 tetor 2011 ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Forcës të Sigurisë së Kosovës (tani Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës) në



lidhje me bashkëpunimin industrial të mbrojtjes të nënshkruar në Ankara. Të dyja palët janë pajtuar që tani t'i zbatojnë objektivat e marrëveshjes në fushat vijuese të bashkëpunimit. Bashkëpunimi duhet të jetësohet duke marrë parasysh interesin e përbashkët dhe nevojat e palëve.

Në FSK mbahet forumi „Procesi i anëtarësimit të Kosovës në NATO"



Prishtinë, 19 dhjetor 2019 - Qendra për Studime Universitare, sipas plan-programit për vitin akademik 2019/2020, ka organizuar Forumin e Sigurisë me temën „Procesi i anëtarësimit të Kosovës në NATO". Në forum ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues të jetës akademike dhe të organizatave joqeveritare dhe ushtarake. Në hapje, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, tha: FSK-ja është produkt i NATO-s dhe se pa NATO-n nuk do të ishim këtu ku jemi sot. Ai, gjithashtu shprehu gatishmërinë e lartë të FSK-së, për bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe në veçanti bashkëpunimin me NATO-n. Pas fjalës hyrëse të gjeneral Ramës, forumi vazhdoi punën me panelistë të tjerë. Temat nga aspekti politik dhe juridik u trajtuan nga panelistët, Dr. Robert Muharremi dhe Mr. Lulzim Peci, ndërsa temën lidhur me strukturimin, edukimin, trajnimin e personelit dhe operacionalizimin e trupave e mbajti gjeneral brigade Jeton Dreshaj. Ndërkaq, Dr. Rachel McGinnis bëri përmbledhjen e diskutimeve të këtij forumi. Nga ky forumi u nxorën çështje të rëndësishme për FSK-në, të cilat do t'i mundësojnë FSK-së dhe Kosovës lehtësimin e rrugës për anëtarësim në NATO. Një çështje e rëndësishme që u diskutua në këtë forum është edhe sfida me të cilën do të përballet Kosova për të plotësuar kriteret që përcakton NATO-ja. Në fund u vlerësua se anëtarësimi i Kosovës në NATO nuk paraqet asnjë kërcenim për rajonin dhe për vet NATO-n, përkundrazi do të jetë një vlerë e shtuar, ku FSK-ja me njësitë e specializuara do të kontribuonte në misione ndërkombëtare paqeruajtëse, në veçanti në misionet e deminimit dhe të kërkim-shpëtimit.

Në MM mbahet konferenca „Lansimi i Planit të Integritetit 2019-2022"



Prishtinë, 17 korrik - Në Ministri të Mbrojtjes u mbajt konferenca „Lansimi i Planit të Integritetit 2019-2022", Në hapjen e konferencës, sekretari Faruk Geci, shprehet: „Një ndër mekanizmat e nevojshëm, krahas mekanizmave tjerë për funksionim dhe kontroll të brendshëm, padyshim ka qenë themelimi i mekanizmit për avancim të integritetit në institucionin tonë". Ndërsa, ministri Rrustem Berisha tha se: „Ky plan është derivat i politikave të MM-së në funksion të fuqizimit dhe zhvillimi të mëtutjeshëm të institucionit tonë sipas misionit të ri. Plani i Integritetit zë vend të rëndësishëm në kuadër të dokumenteve strategjike të MM-së dhe është në përputhje me Strategjinë Kundër Korrupsionit në nivel të shtetit. Integriteti është një vlerë që duhet të mishërohet në punën tonë ditore. Integriteti ngërthen angazhimin individual dhe institucional në funksion të kryerjes së detyrave në përputhje me konceptin e sundimit të ligjit. Plani si i tillë parasheh masa konkrete në drejtim të përmirësimit dhe fuqizimit të segmenteve të rëndësishme në kuadër të MM-së si dhe në nivel të Forcës. Është e rëndësishme që realizimi i këtyre masave ta avancojë menaxhimin e burimeve njerëzore, prokurimit, financave, kontrollit të brendshëm dhe të aseteve". Kurse, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad, në fjalën e tij, ndër të tjera veçoi: „Zbatimi i ligjit në rend të parë është detyrim. Kosova në vazhdimësi ka bërë përpjekje të mëdha për luftimin e kësaj dukurie, por ju sugjeroj që duhet organizuar plane strategjike më të shpeshta sikur kjo për luftimin e korrupsionit". Po ashtu debatit me diskutimet e tyre i kontribuuan edhe drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit Shaip Havolli dhe Svein Eriksen, këshilltar i lartë i Qendrës së Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes nga Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë.

FSK-ja pjesë e ushtrimit ndërkombëtar „Immediate Respo

Zagreb, 8 qershor 2019 - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të shefit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, gjeneralit Mirko Shundov, mori pjesë në ditën e vizitorëve të ushtrimit fushor ndërkombëtar të organizuar nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR)„Immediate Response 19", mbajtur në poligonin ushtarak të stërvitjes në Slunj të Kroacisë, me rastin e shënimit të 10-vjetorit të anëtarësimit të Kroacisë në NATO. Gjeneral Rama në këtë aktivitet pati mundësi të shoh nga afër angazhimin e FSK-së, përfaqësuar në ushtrim nga pjesëtarë të Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe Ekipeve për Eliminimin e Mjeteve Eksplozive të Pashpërthyera, të cilët krahas shteteve partnere dhe atyre të NATO-s treguan përkushtim dhe profesionalizëm të lartë në kryerjen e misioneve bazuar në skenarët e ushtrimit. Ky ushtrim, mes tjerash, promovon stabilitetin dhe sigurinë në rajon por edhe forcon bashkëpunimin dhe rrit besimin në mes të partnerëve. Pjesëmarrja e FSK-së në këtë ushtrim kontribuon në avancimin e kapaciteteve të Forcës si në aspektin e organizimit, përgatitjes dhe të zbarkimit të njësiteve jashtë vendit, por edhe të operimit në mjedis shumëkombësh duke qenë të ndërveprueshëm në të gjitha aspektet e operimit. Në këtë ushtrim morën pjese mbi 1600 ushtarakë nga 15 shtete, të cilët po zhvillojnë operacione stërvitore në disa lokacione duke filluar nga Kroacia, Sllovenia dhe Hungaria. Ushtrimi u realizua nga data 20 maj deri më datë 8 qershor 2019. Kontingjenti i FSK-së në këtë stërvitje ka shfaqur profesionalizëm dhe motivim të nivelit të lartë duke përfaqësuar denjësisht FSK-në, si dhe duke qenë të barabartë me ushtritë partnere dhe ato të vendeve të NATO-s.



Realizohet me sukses trajnimi „Përcaktimi i zonës së aterimit të helikopterit"



nse 19" në Kroaci



Pomozotin, 05 gusht 2019 - Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së në Pomozatin u mbajt kursi „Përcaktimi i zonës së aterimit të helikopterit". Në këtë trajnim u trajtuan tema që lidhen me aerodinamikën dhe funksionimin e helikopterëve. Në veçanti, studentët u njoftuan me kriteret e përzgjedhjes së një zone të përshtatshme për aterim të helikopterëve, me komandat dhe sinjalet e komunikimit me pilotin para aterimit, si dhe mënyrën e evakuimit mjekësor duke përdorur formatin e kërkesës së quajtur „NATO nëntë linjat". Po ashtu, studentët mësuan parimet themelore të bartjes së viktimave me helikopter. Pjesë kyçe të këtij trajnimi ishin njohuritë e sjella nga pilotët e FSK-së, togerëve: Afrim Zabeli, Krenar Voca dhe Atdhe Hasani. Ata me ekspertizën e pilotimit të helikopterit sollën njohurit e tyre të dobishme rreth aerodinamikës së fluturakeve–helikopterëve. Edhe pse temat e trajtuara janë të një spektri më të gjerë, studentët arritën që për një kohë shumë të shkurtër të pajisen me njohuri themelore rreth përcaktimit të zonës së aterimit, varësisht nga zona ku ata mund të jenë caktuar për të operuar. Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim është model jo vetëm për FSK-në, por edhe për rajonin, për gjithë-përfshirjen e njerëzve që më të vërtetë sjellin diçka të mirë dhe të dobishme në kuadër të zhvillimit profesional.

Oficerët e FSK-së që kanë kryer Akademinë Ushtarake „Sandhurst" dekorohen me medalje

Prishtinë, 27 shkurt 2019 - Në Ministrinë e Mbrojtjes u dekoruan me medalje oficerët e FSK-së, të cilët kanë kryer Akademinë Ushtarake „Sandhurst" në Mbretërinë e Bashkuar. Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, përgëzoi oficerët për arritjet e tyre gjatë studimeve në akademinë „Sandhurst". Ai pos tjerash, tha: „Padyshim që synojmë ta rrisim bashkëpunimin me Mbretërinë e Bashkuar, në mënyrë që t'u përgjigjemi nevojave tona në kuadër të zhvillimit të forcës, por edhe të shprehim gatishmërinë që t'i ofrojmë kapacitetet tona, duke kontribuar kështu në ruajtjen e paqes kudo në botë. Si rezultat i bashkëpunimit të ndërsjellë, FSK-ja për herë të parë do të dërgojë një oficer të saj, në detyrën e instruktorit të kësaj akademie të respektuar". Ndërsa, ambasadori Ruairi O'Connell, tha: „Kosova është vendi më i ri në partneritet me vendin tonë, prandaj ndikimi i secilit oficer çdo ditë është i matshëm, është një krenari për vendin tim sepse ne kemi qenë nga fillimi me ju dhe mund të kontribuojmë në Forcën tuaj dhe në storien tuaj. Kjo është ajo që ne mund të bëjmë, duke kontribuar dhe bartur përvojat tona tek ju". Në fund për oficerët e FSK-së u ndanë medalje nga gjeneral Rama, ambasadori O'Connell, atasheu ushtarak nënkolonel Layton dhe koloneli Winser.





MBAHET KURSI BAZIK „MBIJETESA NË DIMËR"

Pomozotin, 15 shkurt 2019 - Në Qendrën Trajnuese për Kërkim-Shpëtim, në terren të hapur u mbajt kursi „Mbijetesa në dimër", ku morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha njësiteve të FSK-së. Kursi kishte për qëllim përgatitjen e pjesëtarëve për mbijetesë dhe përshtatjen e tyre me kushtet ekstreme të motit. Pjesëmarrësit kanë mësuar ndërtimin e strehimoreve për mbijetesë me materialin e gjendur në natyrë, metodat e ndezjes së zjarrit dhe sigurimin e ujit dhe të ushqimit. Po ashtu janë përgatitur edhe për orientimin në natyrë, pa harta dhe busullë, vetëm duke u orientuar përmes; diellit, hënës, yjeve dhe objekteve të tjera në natyrë. Kursi u finalizua me marshimin e pjesëmarrësve në kushte shumë të ftohta moti, në një gjatësi mbi 8 km, duke kaluar në natyrë 36 orë, për t'i praktikuar mësimet e mësuara. Pjesëtarët e FSK-së, të cilët arritën ta përfundojnë me sukses trajnimin, tani janë të gatshëm që t'i bartin njohuritë te njësitet dhe kolegët e tyre. Të gjithë pjesëmarrësit e kursit kanë arritur t'i plotësojnë kriteret e kërkuara dhe janë certifikuar për Nivelin e Avancuar të kursit „Mbijetesa në dimër".



FSK-JA PJESË E USHTRIMIT NDËRKOMBËTAR „WINTER EXERCISE 19" NË TURQI



Turqi, 22 shkurt 2019 - Në qytetin Kars të Turqisë, u mbajt ushtrimi fushor ndërkombëtar „Ushtrimi Dimëror 19" në të cilin morën pjesë përfaqësues nga 13 shtete. Ushtrimi kishte për qëllim testimin e kapaciteteve luftarake në kushte të dimrit si dhe forcimin e ndërveprushmërisë në ambiente të përbashkëta operacionale. FSK-ja mori pjesë me një kontingjent prej shtatë pjesëtarëve të rangut; oficerë dhe nënoficerë-stafi. Kontingjenti i FSK-së, ka zbarkuar më 06 shkurt 2019 dhe i është bashkuar Brigadës së 14-të të Mekanizuar të Ushtrisë Turke, në detyra të ndryshme, si oficerë/nënoficerë stafi, etj. Sipas komandantit të Kontingjentit të FSK-së, majorit Kuqi, të gjithë oficerët dhe nënoficerët e FSK-së ishin në nivel të detyrës duke treguar profesionalizëm të lartë. Qëllimi i pjesëmarrjes së FSK-së, është që pjesëtarët e saj të trajnohen dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë në qitje reale me armë të kombinuara të kalibrave të ndryshme në një operacion konvencional ushtarak, dhe pastaj këto përvoja t'i aplikojmë në vendin tonë në kushte dhe ambiente të ngjashme. Në ditën DV-day ishte i pranishëm edhe komandanti i KFT-së, gjenerali brigade Enver Cikaqi, i cili me ftesë të komandantit të Forcave Tokësore të ushtrisë turke, mori pjesë në përcjelljen e dy ushtrimeve fushore që u realizuan në Turqi, gjatë muajit shkurt. Pjesë e këtij ushtrimi ishin rreth 1750 pjesëtarë nga 15 shtete të rajonit, duke përfshirë Kosovën, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Gjeorgjinë, Azerbajxhanin, Bangladeshin, Bosnjën dhe Hercegovinën, Bullgarinë e të tjera. Pjesëtarët e FSK-së, përfituan nga përvoja e madhe e ushtrisë turke në organizimin e ushtrimeve të tilla me karakter ndërkombëtar dhe këto njohuri do t'iu shërbejnë në organizimin e ushtrimeve fushore në FSK.



MM-ja dhe FSK-ja dhurojnë mbi 1000 doza gjak

Prishtinë, 05 gusht 2019 - Gjatë këtij viti mbi 1000 ushtarakë dhe civilë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, i janë përgjigjur aksionit humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut, për nevoja të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës dhe qytetarëve në nevojë. Aksionit humanitar për dhurimin e gjakut disa iu përgjigjen edhe për të dytën dhe tretën herë brenda këtij viti. Aksioni humanitar i dhurimit vullnetar të gjakut, i dyti për këtë vit, po zhvillohet bazuar në planin e veprimit për vitin 2019 të Departamentit për Bashkëpunim Civil-Ushtarak dhe Drejtorisë së Operacione/Departamenti për Çështje Mjekësore në bashkëpunim me Kompaninë e Mjekësisë dhe Qendrën Kombëtare të Kosovës për



Transfuzionin e Gjakut. FSK-ja arrin që të grumbullojë mbi 1000 doza gjak, të cilat i dhurohen Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut për nevojat e pacientëve në spitalet tona.

Nderohet me medalje drejtori i NALT-it gjenerali Uwe Becker



Prishtinë, 28 qershor 2019 - Në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e pranim-dorëzimit të autoritetit të drejtorit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s nga gjeneral brigade Uwe Becker te gjeneral brigade Michael Oberneyer. Në ceremoni morën pjesë edhe kryeministri Ramush Haradinaj, ministri Berisha, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral D'Adario, zv. shefi i Bundesverit, gjenerali Thorsten Poschwatta si dhe oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, NALT-it. Kryeministri Haradinaj ka falënderuar gjeneralin Becker për kontributin e tij për MM/FSK-në. Ndërsa, ministri Rrustem Berisha çmoi lart angazhimin e gjeneralit Uwe Becker e sidomos koordinimin dhe bashkëpunimin në një fazë shumë të rëndësishme për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. FSK-ja përgjatë 10 viteve është trajnuar dhe zhvilluar me ndihmën e ekspertëve të NATO-s, përmes ekipeve trajnuese, këshillëdhënëse dhe ndërlidhëse. Falë kësaj ndihme dhe ndihmës dypalëshe të aleatëve, FSK-ja është dhe do të vazhdojë të jetë një forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme, ku



Ilojllojshmëria etnik dhe gjinor është dhe do të mbetet vlerë". Në fund, ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama, ndanë mirënjohje dhe medalje për gjeneralin Becker.

Tetari Besnik Nebihu dhe rreshteri Xhevat Malo



Prishtinë, 26 prill 2019 - Nën organizimin e FSK-së, u mbajtën gara e FSK-së dhe gara ndërkombëtar për vitin 2019. Në këto gara morën pjesë 18 ushtarë të 9 shteteve të NATO-s, dhe 22 ushtarë të të gjitha njësive të FSK-së. Tetari Besnik Nebihu nga Brigada e Mbështetjes Operacionale të FSK-së dhe rreshteri Xhevat Maloku nga Republika e Shqipërisë u shpallën më të mirët. Me këtë rast, zv. ministri Burim Ramadani tha: Orientimi dhe përkushtimi ynë si FSK, është të rrisim bashkëveprimin tonë me shtetet aleate të NATO-s. Gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë, promovon vlerat dhe shkëmbimin e përvojave dhe njëherësh ka krijuar miqësi në mes jush, prandaj besoj se

Tetari Liridon Selimi fitoi vendin e dytë në Garën Ushtarake Ndërkombëtare në Kroaci

Kroaci, 13 maj 2019 - Në mesin e pjesëmarrësve nga 13 shtete të Botës, garues të Garës Ushtarake Ndërkombëtare në Republikën e Kroacisë, ushtaraku i Forcës së Sigurisë të Kosovës, tetar Liridon Selimi zuri vendin e dytë, duke u renditur pas ushtarakut rumun rreshter Mera Dorel Silviu si dhe duke lënë pas ushtarin amerikan William Hennesy. Konkursi i këtij viti është organizuar nga Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës „Fran Krsto Frankopan" të Ushtrisë Tokësore Kroate. Konkurrentët e tri kategorive, në një total prej 146 ushtarakësh, kanë zotëruar gjatësinë e përcaktuar të garës prej 40 kilometrave, në kazermën „Josip Joviç" si dhe fushën e Krbava-s. Gara u zhvillua në fazën kualifikuese, pra gjuajtja kualifikuese me armë, që u mbajt më 9 maj 2019 si dhe gara kryesore ku sipas planit duhej të kalohej distanca prej 40 kilometrash, më 12 stacione punuese



dhe 8 pika kontrolli. Stacionet punuese në të cilat u sfiduan ushtarakët garues ishin: navigimi, hedhja e granatës, poligoni i kalitjes, gjuajtje me VHS D2 (automatik), gjuajtje me HS-9 (pistoletë), gjetja e lokacionit në hartë, identifikimi dhe kontrolli i personit, ndihma e parë në fushëbetejë, gjuajtja me AT-4 (antitank), kalimi i zonave të minuara dhe kontaminuara, kalimi i lumit mbi litarë dhe thirrje për zjarr indirekt. Tetari i FSK-së, në një konkurrencë të fortë zuri vendin e dytë.

oku shpallen ushtarët më të mirë për vitin 2019

këtë komunikim do ta vazhdoni edhe në të ardhmen. Komandanti i FT gjeneral brigade Enver Cikaqi, në fjalën e tij, tha se prezenca e 9 shteteve partnere në garë, më së miri e tregon vlerën dhe nivelin e garës. Kjo i jep kuptim të fuqishëm këtij organizimi u shpreh ai, duke i falënderuar në emër të komandantit të FSK-së, për organizimin dhe mbarëvajtjen e kësaj garës. Ndërsa, rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj, tregoi edhe historikun e garës, se si në fillim është marrë shembull gara e zhvilluara në Ajova, e cila më pas është përshtatur në një garë unike të FSK-së, e që tashmë është bërë tradicionale, sfiduese dhe shumë atraktive për garuesit.




FSK-ja fitoi medalje në garën ndër





Shefi i Shtabit i Forcave të Armatosura të Kroacisë viziton FSK-në

Prishtinë, 11 qershor 2019 - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti me ceremoni ushtarake shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, gjeneral kolonelin Mirko Shundov. Ministri Mbrojtjes z. Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama, zhvilluan takim veç e veç me gjeneralin kroat Mirko Shundov. Në takim me ministrin u bisedua për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë në fushën e mbrojtjes si dhe për planet dhe opsionet për vazhdimin dhe avancimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet dy ministrive dhe dy forcave në të ardhmen. Ministri Berisha ka falënderuar gjeneralin kroat për mbështetjen e Kosovës në ndërtimin e paqes dhe stabilitetit, ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve mbrojtëse si dhe përkrahjen e vazhdueshme, bazuar në praktikat e kaluara nga vetë Kroacia, për anëtarësimin e Kosovës në iniciativa rajonale dhe në rrugën drejt NATO-s. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama me shefin e Shtabit të FA të Kroacisë,



gjeneralin Shundov biseduan lidhur me bashkëpunimin në të gjitha fushat me interes të përbashkët. „Për ne Kroacia është partner strategjik në rajon, dhe në kuadër të kësaj, ne diskutuam për bashkëpunimin tonë dypalësh si dhe mundësinë e avancimit të bashkëpunimit në të gjitha fushat", deklaroi gjenerali Rama në konferencën për shtyp. Nga ana e tij, shefi i Shtabit të FA të Kroacisë, gjenerali Shundov deklaroi se Kroacia ka zotim të plotë për vazhdimin dhe avancimin e bashkëpunimit si dhe është e gatshme që të ofrojë gjithë ekspertizën dhe përvojën e saj të kaluar që të ndihmojë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në rrugën e anëtarësimit në iniciativa rajonale dhe me gjerë. Kosova dhe Kroacia kanë marrëveshje të nënshkruar dypalëshe që nga viti 2012, në kuadër të së cilës për çdo vit realizohet një gamë e gjerë e aktiviteteve të planifikuar me interes të përbashkët.

kombëtare „Cambrian Patrol 19"



Angli, 18 tetor 2019 - Në njërën prej garave ushtarake më prestigjioze në botë „Cambrian Patrol 19", ekipi i Forcës së Sigurisë të Kosovës arriti që të rrëmbej „Medaljen e Argjendtë". Gara patrulluese filloi më datën 16 tetor 2019 dhe zgjati 48 orë, pa ndërprerë, ku morën pjesë gjithsej 132 ekipe, prej të cilave 34 ishin nga shtetet e ndryshme. Kjo është hera e tretë që FSK-ja po merr pjesë në garën ndërkombëtare ushtarake „Cambrian Patrol", e cila organizohet nga Brigada e Këmbësorisë 160-të e Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar. Përveç Republikës së Kosovës, në garën „Cambrian Patrol 19" në Mbretërinë e Bashkuar, morën pjesë edhe ekipet e forcave të armatosura të vendeve të rajonit, si nga Maqedonia e Veriut, Bosnja e Hercegovina dhe Greqia. Gara „Cambrian Patrol 19" është një aktivitet shumë sfidues dhe prestigjioz ushtarak që teston të gjitha aftësitë themelore ushtarake të ushtarit të sotëm, duke rritur aftësinë e udhëheqjes dhe nivelin e qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë.

Shefi i Mbrojtjes së Malit të Zi viziton FSK-në



Prishtinë, 27 maj 2019 - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti me ceremoni ushtarake shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, gjeneralin Dragutin Dakiq. Ministri Berisha pasi e falënderoi gjeneralit Dakiq, për angazhimin e Malit të Zi në KFOR dhe në Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MM/FSK, theksoi se synimi i FSK-së mbetet anëtarësi në NATO, dhe bashkëpunimi më të gjitha vendet e rajonit që janë anëtare të NATO-s dhe ato që aspirojnë anëtarësim në NATO, duke qenë të bindur se paqja e përhershme arrihet me anëtarësimin e secilit shtet të rajonit në NATO. Ndërsa, gjeneral Rama me gjeneralin Dakiq biseduan për marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë si dhe për nevojën e zgjerimit dhe avancimit të këtyre marrëdhënieve në të ardhmen. Në takimin me gazetarë, komandanti i FSK-së dhe Shefi i Ushtrisë së Malit të Zi, u shprehën se Mali Zi dhe Kosova kanë marrëdhënie të mira në fushën e mbrojtjes dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndër të tjera, gjenerali Rama tha se synimi i Kosovës është anëtarësimi në NATO dhe integrimi në Bashkimin Evropian. Nga ana e tij, gjenerali Dakiq tha se Mali i Zi promovon idenë e integrimit të Ballkanit perëndimor në strukturat euroatlantike dhe se ky është i vetmi qëllim që garanton paqe dhe stabilitet në rajon.

Nderohen viktimat e sulmit të 11 shtatorit 2001 në SHBA



Prishtinë, 11 shtator 2019 - Me rastin e zbulimit të pllakës memoriale „Kosovo Remembers“ të ngritur në oborrin e Qeverisë së Kosovës, në shenjë nderimi të viktimave të sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, morën pjesë ministri Berisha, zv. ministri Kadri Kastrati, zv. komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, gjeneralët: Gëzim Hazrolli, Fadil Hadergjonaj, Nazmi Brahimaj, Xhevahir Geci dhe Njësia Ceremoniale e Gardës së Kosovës. Pllakën memoriale e zbuluan kryeministri në detyrë Ramush Haradinaj dhe ambasadori i SHBA-ve në Kosovë Philip Kossnet, në të cilën është gdhendur logoja e Qeverisë së Kosovës dhe fjalët „Kosova kujton“ si dhe data 11 shtator 2001. Pas zbulimit të pllakës pjesëmarrësit bënë homazhe në shenjë nderimi dhe përkujtimit të viktimave në SHBA.

Turqia i dhuroi FSK-së një autoblindë për qëllime mjekësore



Prishtinë, 21 qershor 2019 - Në kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së në Prishtinë, u mbajt ceremonia e pranim-dorëzimit të Autoblindës së ndihmës së parë „Cobra 4x4“ donacion nga Republika e Turqisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila me të gjitha pajisjet rezervë kapë vlerën e përgjithshme prej 462.457 dollar. Marrëveshja për pranim-dorëzimin e këtij donacioni u nënshkrua nga atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovë, nënkoloneli Ismail Ersoz dhe oficeri i Departamentit të Logjistikës në Ministrinë e Mbrojtjes, kapiteni Remzi Bushi. Ky donacion si dhe donacionet e shumta të tjera, të cilat i janë dhuruar FSK-së, janë rezultat i bashkëpunimit të mirëfilltë në mes të FSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë, duke u bazuar në marrëveshjen për ndihmën financiare në ngritjen dhe profesionalizmin e FSK-së.

Kosova dhe Franca ava për siguri dhe integrim



GARDA KOMBËTARE E FSK-së NGRIT KAPACITETET



Prishtinë, 24 shtator 2019 - Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, ka urdhëruar fillimin e ngritjes së Gardës Kombëtare sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit. Mbajtja e Aftësive Ekzistuese të cilat deri me tani ishin në vartësi të Brigadës së Mbështetjes Operacionale, kanë kaluar nën komandimin dhe kontrollin e Gardës Kombëtare të udhëhequr nga gjenerali Xhevahir Geci, ndërsa Brigada e Mbështetjes Operacionale ka kaluar në Komandë të Logjistikës, në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, nën komandimin e gjeneralit Naim Haziri. Kjo është dëshmi se FSK-ja po vazhdon me ngritjen dhe riorganizimin e njësive sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit. Garda Kombëtare e FSK-së është njësi vartëse e Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së. Në misionin e ri do të mbajë dhe do të zhvillojë aftësitë operacionale në kuadër të mbështetjes ushtarake për autoritetet civile.

ncojnë partneritetin e euro-atlantike



Paris, 19 shkurt 2019 - Zv. ministri Burim Ramadani dhe sekretarja e Shtetit pranë Ministres së Armatave në Paris, znj. Geneviève Darrieusecq, gjatë takimit kanë ritheksuar vullnetin dhe gatishmërinë për thellimin dhe avancimin e marrëdhënieve dypalëshe midis Kosovës dhe Francës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritashëm, ishte konstatim i përbashkët për detajimin e raporteve dypalëshe në mënyrë që FSK-ja të avancojë edhe më tutje në profesionalizimin e saj, veçanërisht në fushën e edukimit sipas standardeve më të larta demokratike. Kosova e sheh Francën si partner të rëndësishëm në forcimin e institucioneve, si dhe në rrugën tonë për anëtarësim në NATO. Kosova ka qëllim shtetëror integrimet euro-atlantike dhe ne synojmë të jemi vendi i 31-të anëtar i NATO-s, ka thënë, z. Ramadani. Ai, gjatë takimit theksoi përkushtimin e Kosovës për të qenë kontribuuese për sigurinë rajonale dhe globale, duke vlerësuar lart aleancat dhe partneritetet me shtetet e NATO-s. Znj. Darrieusecq, shprehu gatishmërinë e Francës për të punuar ngushtë me Kosovën me qëllim të ndërtimit të paqes, besimit, stabilitetit dhe perspektivës perëndimore për tërë Ballkanin.

Policia e FSK-së aftësohet për mbrojtje të afërt



Paris, 19 shkurt 2019 - Zv. ministri Burim Ramadani dhe sekretarja e Shtetit pranë Ministres së Armatave në Paris, znj. Geneviève Darrieusecq, gjatë takimit kanë ritheksuar vullnetin dhe gatishmërinë për thellimin dhe avancimin e marrëdhënieve dypalëshe midis Kosovës dhe Francës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritashëm, ishte konstatim i përbashkët për detajimin e raporteve dypalëshe në mënyrë që FSK-ja të avancojë edhe më tutje në profesionalizimin e saj, veçanërisht në fushën e edukimit sipas standardeve më të larta demokratike. Kosova e sheh Francën si partner të rëndësishëm në forcimin e institucioneve, si dhe në rrugën tonë për anëtarësim në NATO. Kosova ka qëllim shtetëror integrimet euro-atlantike dhe ne synojmë të jemi vendi i 31-të anëtar i NATO-s, ka thënë, z. Ramadani. Ai, gjatë takimit theksoi përkushtimin e Kosovës për të qenë kontribuuese për sigurinë rajonale dhe globale, duke vlerësuar lart aleancat dhe partneritetet me shtetet e NATO-s. Znj. Darrieusecq, shprehu gatishmërinë e Francës për të punuar ngushtë me Kosovën me qëllim të ndërtimit të paqes, besimit, stabilitetit dhe perspektivës perëndimore për tërë Ballkanin.

FSK-ja pjesë e ushtrimit ndërkombëtar „Zgjidhja e Kombinuar XII"



Gjermani, 19 gusht 2019 - Një kontingjent i FSK-së, i përbërë prej 12 pjesëtarësh, nga 9 gushti mori pjesë në ushtrimin fushor „Zgjidhja e Kombinuar XII" në bazën e Ushtrisë Amerikane për Evropë në Gjermani. Ekipi i FSK-së, në këtë ushtrim i ishte bashkuar Brigadës së Parë të Blinduar Luftarake të Divizionit të Këmbësorisë, në fushën e komunikimit, të personelit, të operacioneve si dhe në fushën e vëzhgimit dhe kontrollimit të zhvillimit të stërvitjes. Gjatë ditëve të ushtrimit, janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme në ngritjen dhe zhvendosjen e ritransmetuesve, sipas nevojave në mbështetje të operacioneve taktike të Batalionit të Parë Xhenier si dhe bashkëpunimit me Kompaninë e Komunikimit-Charlie. Ushtrimi "Zgjidhja e Kombinuar XII", është ushtrim shumëkombësh i operacioneve të unifikuara tokësore, i drejtuar nga Shtabi i Departamentit të Ushtrisë së SHBA-ve. Qëllimi i këtij ushtrimi është stërvitja e forcave të caktuara rajonale të Shteteve të Bashkuara në nivel brigade, në mbështetje të objektivave të Komandës Evropiane të SHBA-s për bashkëpunim dhe siguri, ndërtimin e gatishmërisë me aleatët dhe partnerët e NATO-s.

FSK-ja merr pjesë në ushtrimin ndërkombëtar „Saber Junction 19" në Gjermani



Gjermani, 24 shtator 2019 - Një kontingjent i FSK-së, i përberë nga dy ekipe mjekësore dhe një ekip i Kompanisë për Operacione Civile, që nga data: 10-30 shtator, morën pjesë në ushtrimin fushor ndërkombëtar „Saber Junction 19", i cili u realizua në bazën amerikane „Hohenfels" të Gjermanisë. Pjesëtarët e kontingjentit të FSK-së i janë bashkuar njësive amerikane, sipas misionit të tyre; duke operuar në detyrat e tyre specifike. Krahas Divizionit të Parë të Këmbësorisë së ushtrisë amerikane dhe asaj të Kosovës, në këtë ushtrim kanë marrë pjesë mbi 5400 trupa nga shumë vende të botës, si: Armenia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Italia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Polonia, Rumania, Turqia dhe Ukraina. Ekipet e mjekësisë të FSK-së janë angazhuar në trajtimin e të lënduarve, evakuimin e viktimave dhe mbështetje të tjera mjekësore. Ndërsa, ushtarakët e KOC-it kanë realizuar operacione me civilët. Si njësi e re e krijuar, gjatë operacioneve të këtij ushtrimi, janë mbështetur vazhdimisht nga ekipet e specializuara në fushën e operacioneve civile të ushtrisë amerikane. Gjatë ushtrimit është mbajtur edhe DV- Day. Nga FSK-ja, ushtrimin e përcollën kolonelët Agron Bajrami dhe Gyrner Murati. Ushtrimi kishte për qëllim demonstrimin e aftësive dhe të gatishmërisë për të vepruar dhe punuar në një mjedis të kombinuar shumëkombësh, si dhe shkëmbimin e përvojave me shtetet partnere.



Mbahet „Kursi i Lidershipit për Udhëheqësit e Rinj"




Ferizaj, 03 tetor 2019 - Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, 28-të kursantët realizuan „Kursi i Lidershipit për Udhëheqësit e Rinj", në periudhën kohore 09.09-03.10.2019, nga instruktorë të BMATT-it të ushtrisë së Britanisë. Zhvillimi i lidershipit te kursantët, veçanërisht te lidershipi i bazuar në vlera, është një metodë e udhëheqjes e cila përdor një përzierje të stileve të ndryshme të lidershipit për të arritur efektin më të mirë". Udhëheqësi i ekipit të BMATT-it, kapiteni Anthony Kinsella, shprehet: „Ne jemi krenarë që jemi pjesë e kontributit të vazhdueshëm të Mbretërisë së Bashkuar në institucionet e sigurisë të Kosovës dhe në mënyrë të veçantë në zhvillimin e FSK-së, derisa po kalon në mandatin e ri. Jam i entuziazmuar kur shoh zhvillimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve të BMATT-it me FSK-në, dhe mirëpres mundësinë e ardhshme për bashkëpunim të vazhdueshëm dypalësh në mjedisin e trajnimit".„Kursi i Lidershipit për Udhëheqësit e Rinj", u përmbyll me zhvillimin treditor të ushtrimit„Bohemian Resolve", në të cilin përfshihen ushtrime reale për t'i sfiduar kursantët në kryerjen e operacioneve sfiduese fizike në nivel togu. Qëllimi i këtij kursi është që nënoficerët dhe oficerët e rinj, të mësojnë taktikat e këmbësorisë si një mjet për të zhvilluar udhëheqjen dhe komandimin

FSK-ja shkatërron ortekët e borës në Brezovicë



Brezovicë, 06 shkurt 2019 - Në një lartësi mbidetare mbi 2230 metra dhe mot të keq, ekipet e kërkim-shpëtimit dhe të deminimit të FSK-së, kanë realizuar me sukses misionin e tyre për largimin e ortekëve të borës. Ishte mision i vështirë, por i realizueshëm për ekipet profesionale të FSK-së. Këta ortekë për fat të keq, para ca ditësh morën edhe jetë njerëzish. Pas vlerësimit të situatës nga ekipet e kërkim-shpëtimit të FSK-së, ekipet e deminimit, me gjithë kushtet e vështira, kanë filluar punën më datë 02.02.2019 për largimin e ortekëve të rrezikshëm të borës në kompleksin turistik në Brezovicë. Së pari shkatërruan ortekun e parë me eksploziv, i cili paraqiste rrezik të madh për krijimin e një orteku edhe më të madh dhe shumë të rrezikshëm për qytetarët.



Realizohet me sukses trajnimi „Simboli i ujkut"

Istog, 24 dhjetor 2019 - Komanda e Forcave Tokësore e FSK-së, gjatë muajit dhjetor ka realizuar trajnimin taktik dhe të mbijetesës „Simboli i ujkut", i cili është njëri nga trajnimet më të avancuara dhe me sfiduese me të cilat përballen pjesëtarët e FSK-së. Tashmë, kjo është gjenerata e 5-të që realizon këtë trajnim. Trajnimi u zhvillua në dy faza: teorike dhe atë praktike. Njohuritë e fituara në fazën teorike pjesëtarët e ushtrimit i testuan në fazën praktike. Gjatë fazës finale të gjitha temat e mësuara u aplikuan me saktësi nga pjesëtarët në operacionin final, i cili në fillim u zhvillua në ujin e akullt të Liqenit të Radoniqit dhe më pas vazhdoi me marshime të gjata dhe me detyra të shumta përgjatë gjithë operacionit. Në trajnimin „Simboli i ujkut" pjesëtarët u përballen me vështirësi të mëdha, duke bartur pesha të rënda mbi 40 kg, dhe vetëm me nga një racion ushqim në 24 orë. Trajnimi ka për qëllim testimin dhe avancimin e kapaciteteve taktike, fizike dhe psikike të pjesëtarëve të FSK-së. Trajnimi përfundoi me sulmin në objektiv, i cili u përcoll me marshimin tradicional në kazermën „Ushtarët e NATO-s" në Istog, që simbolizon përfundimin me suksese të një përballje mjaft të vështirë treditore në një gjatësi prej 100 kilometrash, e përcjell edhe me një ndjenjë të papërshkruar krenarie. Në përfundim të këtij trajnimi të gjithë pjesëtarët u pajisen me certifikata dhe me simbolin e ujkut, simbol ky të cilin do ta bartin gjatë gjithë karrierës së tyre ushtarake.



Gara sportive për nde

EKIPET MË TË MIRA U SHPËRBLYEN ME MEDALJE DHE DIPLOMA



Prishtinë, 26 nëntor 2019 - Për nder të 27 Nëntorit-Ditës së Forcës, nga 4-25 nëntor 2019, në FSK, u mbajtën garat sportive në këto disiplina: Futboll i vogël, Volejboll, Ping Pong, Shenjëtari, Shah dhe Kros. Të gjitha vendet e para u shpërblyen me medalje, ndërsa mirënjohje morën të gjithë ata që kontribuuan në realizimin e këtyre garave të zhvilluara në prag të festave të Nëntorit dhe Ditës së Forcës. Në Futboll të vogël; vendin e parë e zuri Regjimenti i Qëndrueshmërisë së Komandës të Logjistikës; vendin e dytë Policia Ushtarake dhe vendin e tretë Batalioni i Parë i BRSH-së. Portieri më i mirë u shpall Florent Sadiku dhe lojtari njëherësh edhe golashënuesi më i mirë Arbenis Demaku. Në Volejboll, vendin e parë e zuri Batalioni i Dytë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, vendin e dytë Kompania Mbështetëse e Shtabit të Përgjithshëm dhe vendin e tretë Regjimenti i Qëndrueshmërisë së Komandës së Logjistikës. Në Ping





r të „Ditës së Forcës"

Pong, vendin e parë e zuri OR7 Arsim Idrizi, vendin e dytë OR3 Izet Dermjani dhe vendin e tretë Shpetim Hasani. Në Shenjëtari, vendin e parë e zuri OF2 Alban Bujupi; vendin e dytë OR8 Enver Bajraktari dhe vendin e tretë OR3 Agron Neziri. Në Shah, vendin e parë e zuri OR7 Ferit Zhdrella, vendin e dytë OR3 Arsim Kelmendi dhe vendin e tretë OR5 Demë Hoxha. Në Kros, vendin e parë në kategorinë e meshkujve e zuri OR1 Armend Neziraj, vendin e dytë OR1 Alban Fazliu dhe vendin e tretë OR1 Gent Dakaj, ndërsa në kategorinë e femrave vendin e parë e zuri OR1 Endrita Brahimi, vendin e dytë OR5 Ermira Statovci dhe vendin e tretë OR5 Mimoza Morina. FSK-ja, që disa vite me radhë është duke organizuar aktivitete të tilla sportive për nder të ditës së saj, me qëllim të aftësimit dhe ngritjes së qëndrueshmërisë së personelit në kryerjen e detyrave të tyre funksionale.







FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 88 • 5 Mars 2020 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Në Ministrinë e Mbrojtjes u mbajt ceremonia e dorëzim-pranimit të detyrës së ministrit

Anton Quni ministër i ri i Mbrojtjes

Ministri i deritashëm, zoti Rrustem Berisha, me protokoll zyrtar i dorëzoi detyrën ministrit të ri të Mbrojtjes, zotit Anton Quni

Prishtinë, 05 shkurt 2020. Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, u mbajt sot ceremonia e dorëzim - pranimit të detyrës së ministrit të ri të Mbrojtjes. Ministri i deritashëm, zoti Rrustem Berisha, me protokoll zyrtar i dorëzoi detyrën ministrit Anton Quni, ku paraprakisht e njoftoi me të arriturat dhe sukseset e deritashme përmes raporteve periodike si dhe aktiviteteve në proces. Zoti Berisha, gjithashtu e njoftoi zotin Quni dhe njëkohësisht i dorëzoi edhe aktet kryesore legjislative dhe dokumentet strategjike e planifikuese, me të cilat zhvillon dhe zbaton funksionimin e saj Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, tani, dhe në të ardhshmen. Ndër të tjera, zoti Berisha, theksoi se „duke e njohur dhe pasur mik e shok lufte, pastaj bashkëpunëtor të ngushtë gjatë shërbimit në TMK dhe FSK, si dhe duke njohur cilësitë njerëzore, morale, kombëtare e profesionale të ministrit Quni, kam besimin



e plotë se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja do të arrijnë objektivat strategjike që janë edhe interesi ynë kombëtar". Ndërsa, ministri Anton Quni, falënderoi përzemërsisht ministrin Berisha për angazhimin dhe të arriturat e deritashme, duke e përgëzuar për sukseset e mëdha të arritura gjatë mandatit të tij. Në ceremoni ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, z. Faruk Geci, drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Inteligjencë gjeneralmajori Gëzim Hazrolli dhe shefi i kabinetit Jashar Ramadani.

Biografia e Ministrit të ri të Mbrojtjes

Anton Quni ka lindur në fshatin Fshaj të Gjakovës, më 9 qershor 1967. Familja e tij qysh herët janë shpërngulur nga fshati dhe janë vendosur në Prizren. Antoni shkollën fillore e ka kryer në Bishtazhin-Gjakovë, ndërsa të mesmen në Shkollën e Mesme Ushtarake në Beograd, si dhe ka kryer Akademinë Ushtarake në Beograd/Sarajevë, ku është graduar Oficer i Karrierës.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë, Antoni braktisi Zvicrën pa hezitim, duke iu përgjigjur kushtrimit për t'i dalë zot atdheut. Ishte komandant i Batalionit të UÇK-së për Vëzhgim dhe Aktivitet Diversant dhe shef i Stafit i Brigadës „Agim Ramadani" të UÇK-së. Antoni përkrah Agim Ramadanit, Salih Çekajt, Xhemajl Fetahajt e shumë ushtarakëve të tjerë eminent mori pjesë në Betejën e Koshares, duke korrur fitore historike ndaj forcave ushtarake serbe.

Pas luftës, Antoni ka shërbyer në Trupat e Mbrojtjes të Kosovës (TMK); shef i Shtabit i Komandës për Trajnim dhe Doktrinë, shef i Shtabit i Qendrës për Trajnim Kolektiv të TMK-së, si dhe në Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK) këshilltar Ushtarak i KOMFSK-së.

Në Kabinetin e ish- Presidentit të Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, ka qenë përgjegjës për Sigurinë Kombëtare. Nga viti 2010, Anton Quni ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës. Gjatë këtij mandati si deputet është përzgjedhur edhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e AKI-së (Agjencia e Kosovës për Inteligjencë) dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të Sigurisë.

Antoni është anëtar i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), nga radhët e së cilës vjen edhe si ministri i ri i Mbrojtjes.

Antoni është i martuar me znj. Mirjana dhe është prind i katër fëmijëve.

Komandanti i Komandës Mbështetëse nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë viziton FSK-në



Prishtinë, 21 shkurt 2020. Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), në një vizitë treditore qëndroi komandanti i Komandës Mbështetëse i FARSH-së, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku. Gjeneral Sallaku është pritur në një takim të veçantë nga ministri i Mbrojtjes Anton Quni, i cili i ka shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin në vijimësi të MM-së dhe FARSH-së në të gjitha arritjet e MM-së dhe FSK-së. Gjeneral Sallaku e uroi Ministrin Quni për detyrën e ministrit të Mbrojtjes. Po ashtu, gjeneral Sallaku është pritur edhe nga zv. komandanti i FSK-së gjeneralmajor Enver Cikaqi, i cili e ka njoftuar gjeneralin me të arriturat e deritashme të FSK-së, procesin e tranzicionit nëpër të cilin po kalon FSK-ja si dhe me objektivat e saj për të ardhmen. Me pas të gjithë së bashku kanë vizituar Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ku janë mirëpritur nga shefi i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, me ç'rast është njoftuar me të arriturat e deritanishme dhe objektivat për të ardhmen. Komandanti i Komandës së Logjistikës gjeneral brigade Naim Haziri, në cilësi të nikoqirit dhe homologut, në një takim të veçantë e ka njoftuar në hollësi gjeneral Sallakun me aktivitetet që realizon Komanda e Logjistikës e FSK-së. Së bashku kanë folur edhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në mes dy komandave respektive. Gatë vizitës, gjeneral Sallaku dhe delegacioni i tij, kanë vizituar edhe Regjimentin e Qëndrueshmërisë dhe Regjimentin e Mjekësisë, ku kanë parë nga afër funksionimin e njësive të këtyre regjimenteve. Të dy gjeneralët u zotuan se do të punojnë në shkëmbimin e përvojave dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, me fokus përmbushjen e misionin ligjor të njësive homologe dhe ofrimin e potencialit ekzistues në funksion të bashkëpunimin rajonal në të mirë të paqes, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së përgjithshme. Gjeneral Sallaku gjatë vizitës së tij është shoqëruar nga atasheu i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës, kolonel Eduard Bala.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama merr letra urimi për Ditën e Pavarësisë

Prishtinë, 17 shkurt 2020. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të SHBA-ve, gjeneral Mark A. Milley, i ka dërguar letër urimi komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Në letër urimi, gjenerali Mark Milley, uron gjeneral Ramën dhe të gjithë pjesëtarët e FSK-së, për përvjetorin e 12 të pavarësisë së vendit duke përgëzuar për përparimin e madh në krijimin e një force multi-etnike. Ai në urim shprehu vlerësimin e lartë për angazhimin e gjeneral Ramës, që FSK të realizoi misionin e saj si forcë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Si ushtaraku më i lartë amerikan, gjeneral Milley, shprehu vlerësimin e ushtrisë amerikane për bashkëpunimin dhe miqësinë me Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke çmuar lartë kontributin e saj të rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin.



Ministri Anton Quni priti ambasadorin e Gjermanisë, z. Christian Held

Prishtinë, 06 shkurt 2020. Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës z. Anton Quni, priti në takim, për herë të parë që nga emërimi në detyrë, ambasadorin fuqiplotë të Republikës së Gjermanisë në Republikën e Kosovës Christian Heldt. Fillimisht, ministri Quni shprehu falënderimin e tij për popullin dhe Qeverinë e Gjermanisë për gjithë ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë për Kosovën dhe për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.



Nga ana e tij, ambasadori i Gjermanisë Christian Heldt duke i uruar detyrën ministrit Anton Qunit, konfirmoi qëndrimin e Gjermanisë për vazhdimin dhe thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit, si dhe konkretizimin e aktiviteteve dhe shkëmbimit të përvojave të përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama qëndroi për vizitë zyrtare në Francë

Prishtinë, 17 shkurt 2020 Me ftesë të ambasadorit të Republikës së Kosovës në Francë, z. Qëndrim Gashi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka qëndruar në Paris për të marrë pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Francë, me rastin e 12-vjetorit të Pavarësisë. Në kuadër të kësaj vizite treditore, gjeneral Rama ka marrë pjesë në ceremoninë e „ndezjes së flakadanit nën Harkun e Triumfit“, ngjarje kjo e cila shënohet në përkujtim të ushtarëve francezë të rënë në misionet paqeruajtëse



në Botë. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm edhe ambasadori Gashi si dhe delegacioni shoqërues i komandantit të FSK-së. Gjatë vizitës përkatëse gjeneral Rama u takua edhe me autoritete të larta të Ministrisë së Armatave të Republikës së Francës, të cilët i njoftoi me të arriturat e deritashme të FSK-së, me procesin e tranzicionit, si dhe objektivat strategjike të FSK-së në të ardhmen. Po ashtu, nga të dyja palët janë diskutuar mundësitë e rritjes së bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes përmes nënshkrimit të marrëveshjes dypalëshe. FSK-ja me ndihmën e partnerëve të saj strategjikë vazhdon t'i zgjerojë aftësitë dhe kapacitetet e saj në përputhje me mandatin sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, në mënyrë që të mund t'i kontribuoi paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Ministri Anton Quni priti ambasadorin e Turqisë, z. Çagri Sakar

Prishtinë, 12 shkurt 2020 Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Anton Quni, priti sot në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, z. Çagri Sakar. Me këtë rast, ministri Quni e falënderoi ambasadorin Sakar për vizitën e tij. Ai, gjithashtu, shprehu falënderimin për Republikën e Turqisë, për ndihmën dhe mbështetjen e ofruar në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale ushtarake të FSK-së. Ministri Quni shprehu besimin e plotë se bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Turqisë do të intensifikohen edhe më tej në funksion të arritjes së objektivit për arritjen e aftësive dhe kapaciteteve të plota të FSK-së, për të mundësuar kështu ofrimin e kontributit të Kosovës për paqen, sigurinë dhe stabilitetin rajonal e global, në operacione paqeruajtëse krahas vendeve partnere në mesin e të cilave është edhe Turqia. Nga ana e tij, ambasadori Çagri Sakar e falënderoi ministrin Quni për pritjen dhe i uroi detyrën e re, si dhe premtoi se Turqia, si një vend mik dhe aleat i fuqishëm i Kosovës, sikur deri më tash do të vazhdojë ta ndihmojë dhe mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, në të gjitha fushat dhe komponentët në mënyrë që t'i përmbushë me sukses të plotë synimet e saja. Gjatë takimit, ministri Quni u shoqërua nga shefi i Kabinetit Jashar Ramadani dhe këshilltari ushtarak, koloneli Hamdi Pollomi, kurse ambasadori Sakar u shoqërua nga atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovë, koloneli Ismail Ersoz.



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama i ndanë mirënjohje ish-ministrit Rrustem Berisha

Prishtinë, 10 shkurt 2020 Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, organizoi koktej lamtumirës për ministrin e deritashëm të Mbrojtjes z. Rrustem Berisha. Gjeneral Rama, në fjalën e tij, shprehu mirënjohjen e lartë për angazhimin dhe kontributin e çmueshëm që dha ministri Berisha, gjatë mandatit të tij, duke ven theksin në vendimin historik të arritur në vitin 2018, kur FSK-ja legjitimoi mandatin e plotë ushtarak nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ndër të tjera, gjenerali Rrahman Rama, vlerësoi lart përkushtimin



dhe profesionalizmin e ministrit Berisha edhe në procesin e zbatimit të vitit të parë të tranzicionit të Ministrisë dhe Forcës, si ministër i parë i Mbrojtjes në Republikën e Kosovës. Si simbolikë të falënderimit dhe mirënjohjes së lartë, në emër të të gjithë pjesëtarëve të FSK-së dhe zyrtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama së bashku me sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes z. Faruk Geci nderuan ministrin Berisha, me një punim artistik; me të gjitha logot dhe emblemat e Ministrisë dhe njësive të FSK-së. Për bashkëpunimin e frytshëm dhe korrekt, ministrin Berisha, me mirënjohje e nderoi edhe drejtori i NALT-it, gjenerali Michael Oberneyer. Nga ana e tij, ish-ministri Berisha, falënderoi gjeneral Ramën, sekretarin Geci dhe gjithë personelin e Ministrisë dhe pjesëtarët e FSK-së, për angazhimin, përkushtim dhe profesionalizëm e lartë, që rezultuan me zbatimin e plotë të objektivave të synuar gjatë mandatit të tij. Në vazhdim, Ai falënderoi edhe gjeneralin Oberneyer dhe stafin e NALT-it, për kontributin e madh në mbështetje të Ministrisë dhe Forcës me këshilla profesionale, që mundësuan zhvillimin në vijimësi sipas standardeve të ministrive dhe ushtrive të vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s. Ministri Berisha, në fund, shprehu besimin e plotë se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, do të avancojnë më tej dhe sigurt me pasuesin, me bashkëluftëtarin, bashkëpunëtorin dhe mikun e tij të ngushtë, ministrin e ri z. Anton Qunin, duke ofruar edhe në të ardhmen mbështetjen e tij të plotë në çdo fushë përkatëse.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ministri Anton Quni priti ambasadoren e Kroacisë, znj. Danijela Barishiq



Prishtinë, 13 shkurt 2020. Në vazhdën e pritjeve të ambasadorëve të vendeve mike, ministri i Mbrojtjes Anton Quni, priti sot në takim ambasadoren e Republikës së Kroacisë në Kosovë, znj. Danijela Barišić. Duke i shprehur mirëseardhje, ministri Quni shprehu mirënjohjen e thellë për Republikën e Kroacisë, për përkrahjen e ofruar deri më tani në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e gjithmbarshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Mbështetjen e ofruar për zhvillimin e kuadrove profesionale me shkollimet dhe trajnimet në qendrat specialistike dhe akademinë ushtarake të ofruar në vazhdimësi, Ministri Quni e vlerësoi me rëndësi dhe ndikim të lartë në realizimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-së siç është edhe Kroacia me forcat e armatosura të saj. Ministri Quni e njoftoi ambasadoren edhe me procesin e zbatimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit duke ritheksuar se ky proces, si deri më tani, do të realizohet në transparencë të plotë dhe në përputhje me kornizën kohore të planifikuar si dhe në bashkëpunim dhe bashkërendim të plotë me vendet partnere. Nga ana e saj, Ambasadorja Barišić, falënderoi për pritjen dhe uroi Ministrin Quni për detyrën e re dhe premtoi se Kroacia si një vend mik i Kosovës, sikur edhe deri më tash, do të vazhdojë të mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në të gjitha fushat dhe komponentët e tyre në mënyrë që të përmbushë me sukses të plotë synimet e tyre, respektivisht procesin e tranzicionit sipas planit përkatës. Në fund, të dy ishin të një qëndrimi që të intensifikohet edhe më tej bashkëpunimi dypalësh në funksion të integrimit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë dhe mbrojtjes në funksion të plotë për garantimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

Ministri Anton Quni priti ambasadoren e Holandës, znj. Gerrie Willems



Prishtinë, 18 shkurt 2020 - Në vazhdën e vizitave të ambasadorëve të vendeve mike, ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni priti ambasadoren e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, znj. Gerrie Willems. Në fillim, ambasadorja Willems e uroi ministrin Quni për Ditën e Pavarësisë dhe detyrën e re si ministër i Mbrojtjes. Duke i uruar mirëseardhje, ministri Quni shprehu falënderimin për Mbretërinë e Holandës në mbështetjen e ofruar deri më tani në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e gjithmbarshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ministri Quni theksoi se mbështetja e deritashme me trajnime dhe pajisje specialistike e Holandës ka qenë shumë e rëndësishme për ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e kuadrove profesionale me ndikim të lartë në realizimin e aftësive dhe kapaciteteve operative të ndërveprimit me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-së, siç është edhe vet Holanda. Ministri Quni e njoftoi ambasadoren edhe rreth ecurisë së zbatimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, duke ritheksuar se ky proces, si deri më tani, do të realizohet në transparencë të plotë dhe në përputhje me kornizën kohore të planifikuar, si dhe në bashkëpunim dhe bashkërendim me vendet partnere. Lidhur me interesimin e ambasadores për idenë e shërbimit të obligueshëm ushtarak, ministri Quni theksoi se "çdo propozim apo veprim ynë do të ndërmerret në bashkërendim dhe pajtueshmëri të plotë me partnerët tanë me të cilët kemi rrugëtuar deri këtu, dhe fuqishëm do të jemi bashkë edhe në të ardhmen".

Ai ritheksoi edhe një herë se FSK-ja është dhe do të jetë forcë bashkëkohore me vlera dhe standarde të vendeve të NATO-s, nën kontrollin civil demokratik dhe gjithnjë në shërbim të paqes, qëndrueshmërisë dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë. Nga ana e saj, ambasadorja Willems premtoi se Holanda, sikur edhe deri më tash, do të vazhdojë të mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në përmbushjen e synimeve, respektivisht të procesit të tranzicionit sipas planit përkatës. Në fund, ministri Quni dhe ambasadorja Willems dolën me qëndrim të njëjtë për intensifikimin e bashkëpunimit dypalësh mes dy vendeve mike në fushën e mbrojtjes.

Ambasadori i Shqipërisë, z. Qemal Minxhozi, uron ministrin e Mbrojtjes Anton Quni



Prishtinë, 25 shkurt 2020. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni priti në takim zyrtar ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë z. Qemal Minxhozi. Në fillim, ambasadori Minxhozi, në emër të tij dhe të ministres Xhacka, i uroi përzemërsisht ministrit Quni detyrën e re. Duke vlerësuar lart personalitetin dhe profilin ushtarak dhe politik të ministrit Quni, ai shprehu besimin e plotë në suksesin e Ministrisë dhe të Forcës në procesin që po kalojnë. Gjithashtu, ambasadori Minxhozi shprehu konsideratë për nivelin e lartë të bashkëpunimit dypalësh, njëherësh ofroi gatishmërinë e Republikës së Shqipërisë me të gjitha kapacitetet e saj. Ai ndër të tjera u shpreh: "Si vend anëtar i NATO-s, Shqipëria ofron mbështetje të parezervë në zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të FSK-së në njohjen dhe aderimin e Kosovës në mekanizmat e sigurisë rajonale dhe euroatlantike". Ndërkaq, ministri Quni falënderoi ambasadorin Minxhozi duke shprehur mirënjohjen e tij të thellë për mbështetjen e përhershme të Republikës së Shqipërisë në të gjitha periudhat dhe në arritjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës. Ai, veç tjerash, vlerësoi kontributin në profesionalizimin e kuadrove ushtarake të FSK-së, përmes trajnimeve dhe shkollimeve, si dhe kontributin e oficerëve shqiptarë në kuadër të ekipit këshillëdhënës të NATO-s. Ministri Quni, theksoi nevojën e intensifikimit të aktiviteteve dhe thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve vëllazërore mes dy shteteve, ministrive dhe forcave në funksion të interesave të përbashkëta dhe në funksion të paqes, qëndrueshmërisë dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Ministri Anton Quni priti ambasadorin e Sllovenisë

ministrit të Mbrojtjes. Ai në fjalën e tij shprehu gatishmërinë e shtetit slloven, që përmes mekanizmave të tij të sigurisë dhe mbrojtjes do të vazhdojë ta mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes në arritjen e objektivave të saj. Ministri Quni nga ana e tij falënderoi dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen e deritashme të Sllovenisë në të gjitha fushat, qoftë përmes kontributit të kontingjentit ushtarak në kuadër të KFOR-it, qoftë në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të Ministrisë dhe Forcës, përmes oficerëve e zyrtarëve të saj në Ekipin Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s. Ai gjithashtu kërkoi nga shteti slloven mbështetjen e Kosovës, duke ofruar përvojën e tyre të aderimit në rrugën e integrimit evropian dhe euroatlantik në strukturat përkatëse. Ministri Quni, rreth interesimit të ambasadorit Bertoncelj, për propozimin lidhur me shërbimin e obligueshëm ushtarak, theksoi se „Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, janë në proces të realizimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, proces i cili do të zhvillohet në mënyrë transparente, brenda kornizës kohore të planifikuar, në transparencë të plotë dhe si gjithmonë në koordinim me partnerët tanë". Në fund të dy bashkëbiseduesit u pajtuan për vazhdimin e bashkëpunimit në funksion të paqes dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Presidenti i Kosovës uron pjesëtarët e FSK-së, në 12 vjetorin e shpalljes së Pavarësisë



Prishtinë, 18 shkurtë 2020. Në shënimin e 12-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi ka vizituar kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Në cilësinë e Komandantit Suprem të FSK-së, ai iu është drejtuar me një fjalim pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës të rreshtuar me këtë rast. Në shoqërim të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, presidenti Thaçi, vuri kurorë me lule pranë obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri. Duke kujtuar rrugëtimin e vështirë për

Në 12 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Kryeparlamentarja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti vizituan kazermën e FSK-së "Adem Jashari"



Prishtinë, 17 shkurt 2020. Me rastin e 12- vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë e vizituan kryetarja e Kuvendit e Republikës së Kosovës znj. Vjosa Osmani dhe kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti. Të shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ata u përcollën me nderime ushtarake të Gardës Ceremoniale të FSK-së në prani të shumë pjesëtarëve të FSK-së. Në fjalën e saj, kryetarja e Kuvendit Osmani, vlerësoi lart angazhimin me përkushtim e profesionalizëm të lartë si dhe sakrificën me vetëmohim të pjesëtarëve të FSK-së në shërbim të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit dhe qytetarëve të saj. Ndër të tjera ajo tha se „Të jesh ushtarak nuk është e lehtë. Rreziqet permanente e bëjnë punën tuaj jashtëzakonisht të vështirë. Si përkrahësit më të mëdhenj të paqes ju keni sakrifikuar në momentin që keni vendosur uniformën në trupin tuaj në shërbim të punës dhe luftës për të mirën e vendit tonë. Pra, vendimi i juaj për të sakrifikuar jetën tuaj në shërbim të vendit dhe qytetarëve është vendim i shenjtë". Ndërsa, kryeministri Kurti në fjalimin e tij falënderoi të gjithë pjesëtarët e FSK-së për shërbimin ndaj vendit dhe më gjerë. Ndër të tjera, ai, duke theksuar rëndësinë e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, adresoi premtimin për fokusim më të madh në të ardhmen të Qeverisë së Republikës të Kosovës për FSK-në, respektivisht rritjen e buxhetit në fushën e mbrojtjes. Ndër të tjera ai tha se „Uniforma e juaj është mishërimi i sakrificës sonë kombëtare, i krenarisë dhe aspiratave qytetare e njerëzore. Pa ushtri e pa mbrojtje jemi të dobët, prandaj ne mburremi me shërbimin tuaj dhe qëllimin tuaj fisnik. Nevoja për të mësuar nga disiplina e ushtarit, nga puna dhe dashuria e madhe për t'i shërbyer vendit janë ato që na shtyjnë që të bëjmë shërbimin ushtarak të obliguar pasi që përvojat dhe mësimet e fituara gjatë shërbimit ushtarak na duhen për t'u përballur edhe me betejat e paqes". Në këtë ceremoni festive përveç autoriteteve më të larta të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së të prirë nga ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama si nikoqir, morën pjesë edhe autoritete tjera qeveritare, ambasadorë e ushtarakë të vendeve mike, personalitete e përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare.

Ministri dhe komandanti i FSK-së, bënë nderime në Kompleksin Memorial „Adem Jashari" në Prekaz



Prishtinë, 18 shkurt 2020. Me rastin e 12- vjetorit të Pavarësisë së Republikës të Kosovës, autoritetet më të larta të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës të prirë nga ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama kanë bërë nderime në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Me këtë rast Ministri Quni ka shprehur vlerësimin më të lartë ndaj sakrificës së familjes Jashari për lirinë dhe pavarësinë e vendit." 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së vendit është e lidhur ngushtë me flijimin e Jasharajve dhe luftën epike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, andaj sot dhe gjithmonë përkulemi dhe rrugëtojmë përpara me nderimin dhe respektin më të thellë për ta ", ka thënë ministri Quni. Kurse, gjeneral Rama theksoi se duke e kujtuar të kaluarën tonë me lavdinë e Familjes Jashari, Komandantit Legjendar Adem Jashari, si dhe gjithë sakrificës ndër breza, jemi duke ndërtuar dhe zhvilluar ushtrinë tonë si garanci e lirisë dhe pavarësisë së vendit. „Në këtë ditë festive, vlerësoj se të gjitha të arriturat e deritashme të FSK-së dhe objektivat tonë për përmbushjen e misionit kushtetues, janë të ndërlidhura me frymëzimin që marrim nga madhështia e përhershme e Jasharajve dhe Komandantit Legjendar Adem Jashari" u shpreh ai.



liri dhe pavarësi me shumë mund e sakrificë, presidenti Thaçi, vlerësoi lart përkushtimin e jashtëzakonshëm të të gjithë pjesëtarëve për ndërtimin, zhvillimin dhe fuqizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës në shërbim të vendit dhe qytetarëve pa dallim. “Pjesëtarët e FSK-së janë dhe do të mbeten krenaria më e madhe e vendit. Është nder dhe privilegj të jem në mesin tuaj, në këtë ditë të madhe historike dhe të bekuar. Për të ardhur deri në këtë ditë që Kosova të ketë ushtrinë e vet, u deshtë shumë mund e luftë, përpjeke e durim dhe përgatitje sistematike. Ushtria e Kosovës u rrit së bashku me vitet e lirisë, pavarësisë dhe zhvillimit të saj. Ushtarë të nderuar, bazamenti i ushtrisë së Kosovës është gjaku i derdhur për liri.” tha ai. Presidenti Thaçi , gjithashtu, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e pazëvendësueshëm të vendeve mike në ndërtimin e FSK-së si ushtri moderne me vlera dhe standarde të ushtrive të vendeve të NATO-s. Vlera dhe standarde të cilat u kurorëzuan me epitetin e merituar qytetar si institucioni më i besuar i sigurisë në vend. “Ushtria e Kosovës është shembulli më i mirë i bashkëpunimit me shtetet mike të cilat na u gjenden afër në momentet më kritike të historisë sonë. Qytetarët dhe shteti ynë krenohemi me ju, andaj me plot meritë jeni institucioni që gëzoni respekt të gjerë në vend”, tha ndër të tjera ai. Vizita e Presidentit Thaçi përmbylli edhe aktivitetet e organizuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së në shënim të 17- Shkurtit –Ditës së Pavarësisë së vendit.

Intervistë me drejtorin e Qendrës Mjekësore të Forcës së Sigurisë të Kosovës, Dr. Shkëlzen Sylaj

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet FSK-së dhe SHSKUK-së

Forca Jonë: Zoti drejtor, ditë më parë keni nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës. A mund të na thoni diçka më shumë?

Dr. Shkëlzen Sylaj: Siç jeni të njoftuar më datën 19.02.2020 në objektin e administratës së SHSKUK (Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës) me moton “Ushtari i shëndosh në mbrojtje të Atdheut”, së bashku me drejtorin e përgjithshëm të SHKSUK – së, Dr. Basri Sejdiu në prezencë të gjeneral major Enver Cikaqit ZVKOMFSK dhe zyrtarëve të lartë të SHSKUK-së, QMFSK-së dhe FSK-së, kam nënshkruar Marrëveshjen e bashkëpunimit në mes SHSKUK–së dhe QMFSK.



Forca Jonë: Cili është qëllimi i këtij memorandumit dhe fushat në të cilat do të punohet?

Dr. Shkëlzen Sylaj: Kjo marrëveshja ka për qëllim përkrahjen në funksionalizimin e Qendrës Mjekësore të FSK–së, në shërbim të pjesëtarëve të FSK–së, ku mjekë specialistë dhe teknikë profesionalë nga klinikat universitare dhe spitalet rajonale do të ofrojnë shërbime për të gjithë pjesëtarët, të cilët janë gjithmonë të gatshëm të zbatojnë detyrën e tyre për t’i dalë në ndihmë vendit tonë. Motoja jonë është “ Ushtari i shëndosh në mbrojtje të Atdheut” prandaj ne do të kemi një vëmendje të veçantë për shëndetin e secilit ushtar që shërben në Forcën e Sigurisë së Kosovë.

Forca Jonë: Zoti Sylaj, sa është i rëndësishëm ky bashkëpunimi për zhvillimin profesional të kuadrove mjekësore të FSK-së?

Dr. Shkëlzen Sylaj: Kjo marrëveshje përveç përkrahjes në funksionalizimin e Qendrës Mjekësore të FSK–së, në shërbim të pjesëtarëve të FSK–së, gjithashtu është edhe një hap i rëndësishëm në kuadër të realizimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të FSK–së. Ndërsa rol të veçantë do të luaj në zhvillimin dhe ngritjen profesionale të kuadrove mjekësor në qendrën mjekësore si dhe në përgjithësi të personelit mjekësor në FSK, ku në kuadër të këtij bashkëpunimi do të ketë shkëmbim të përvojave në mes të personelit të QM-së dhe klinikave të QKUK-së.

Forca Jonë: Në planin Tuaj të afërt a keni paraparë ndonjë bashkëpunim tjetër të kësaj natyre?

Dr. Shkëlzen Sylaj: Në kuadër të konceptit zhvillimor që ka QMFSK-ja, parashihet që të ketë marrëveshje edhe me institucionet tjera shëndetësore të Kosovës, si p.sh. me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, i cili do t’i ofrojë përkrahje FSK–së, në vlerësim të situatës epidemiologjike në vend dhe rajon, varësisht nevojave që ka FSK-ja. Do të finalizoj marrëveshjen me Spitalin Ushtarak “Qendrën Kombëtare të Traumës” në Tiranë, me të cilët aktualisht kemi bashkëpunim të mirëfilltë. Siç jeni të njoftuar FSK-ja ka marrëveshje me spitalet ushtarake të Turqisë, ku çdo vit shteti turk ofron shërbime për 50 raste pa pagesë, për pjesëtarë dhe shërbyes civilë të MM-së dhe FSK–së dhe familjarë të tyre. Kurse do të vazhdojmë me zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit edhe me ushtritë e të gjitha shteteve partnere me të cilat kemi të nënshkruara marrëveshje dypalëshe si dhe me shtetet tjera të cilat janë të gatshme të përkrahin FSK– në në këtë fushë.

Forca Jonë: Zoti drejtor, cilat janë planet e Juaja konkrete për zhvillimin dhe profesionalizimin e Qendrës Mjekësore të FSK-së?

Dr. Shkëlzen Sylaj: QMFSK-ja është institucioni më i lartë diagnostikues, mjekues dhe parandalues për mjekësinë ushtarake, që gjithashtu do të sigurojë mbështetje mjekësore në parandalimin e sëmundjeve dhe epidemive, si dhe të sigurojë bashkëpunim profesional mjekësor nga nivelet më të larta shëndetësore publike. QM-ja ka të zhvilluar planin i cili parasheh 3 faza të zhvillimit, duke përfshirë këtu kompletimin me pajisje adekuate, rekrutimin e plotë të personelit mjekësor sipas strukturës, kompletimin e infrastrukturës ligjore për funksionim, si dhe fillimin e bashkëpunimit me institucionet shëndetësore ushtarake të shteteve partnere.

Kapiteni Getoar Rexhepi kreu trajnimin „Kursi i kapitenit të karrierës – manovrave" në SHBA



Prishtinë, 10 shkurt 2020. Kapiteni i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), Getoar Rexhepi, ka filluar trajnimin „Kursi i kapitenit të karrierës–manovrave" në SHBA, më 30 qershor 2019 dhe e ka përfunduar më 31 janar 2020, në Qendrën e Manovrave të Ekselencës të Ushtrisë Amerikane (Maneuver Center of Excellence) në Fort Benning Ga-SHBA–ve. Objektiv i këtij trajnimi është të nxjerrë lider të shkathët, të përshtatshëm dhe me njohuri për zhvillimin e operacioneve luftarake. Të diplomuarit nga ky kurs, demonstrojnë aftësi të shkëlqyeshme në shkencën e planifikimit taktik në kompani, batalion dhe kuptim operacional në nivel brigade. Kursi është zhvilluar në tri faza: faza e kompanisë, faza e batalionit dhe faza e trajnimit të njësisë. Në fazën e kompanisë, objektivi është të arrihet mjeshtëria e Procedurës së Udhëheqjes së Trupave (PUT), përgatitja dhe brifimi i urdhrave sipas doktrinës amerikane, terminologjisë ushtarake, grafikeve operacionale në planifikim dhe brifim të operacioneve; me këmbësori, tanke Abrams M1A2, Bradley, Stryker, si dhe operacione me degë të tjera ushtarake dhe forcave ajrore. Në fazën e batalionit objektiv, është perfeksionimi i Procesit të Vendimmarrjes Ushtarake (PVMU-MDMP) në doktrinën amerikane, detyrat e ndryshme të oficerit të Shtabit në operacione ofensive, defenzive, stabilitetit (në fazën e tranzicionit) si dhe Combine Arms Operations, duke brifuar brifigjet e Urdhrave dhe Combined Arms Rehearsal sipas standardit. Në fazën e trajnimit të njësisë (Unit Training Management-UTM) kursi fokusohet në planifikimin e planit të trajnimeve, zhvillimin dhe trajnimin e njësisë, planifikimin taktik për qitje të njësisë me zjarr real, me trupa gjatë zhvillimit të një operacioni specifik ose drillet e betejës. Trajnimi në fjalë ofron edhe Programin "Field Studies" si pjesë obligative e kursit, ku, studentët ndërkombëtarë kanë mundësinë të shohin për së afërmi mënyrën amerikane të jetesës, liritë, të drejtat, kulturën që e gëzon populli amerikanë. Kursi i Kapitenit të Karrierës-Manovrave (Maneuver Captains Career Course-MCCC) zhvillon dhe edukon studentët, oficerë që të udhëheqin njësi në nivel kompanie si dhe të shërbejnë oficerë të Shtabit në mbështetje të operacioneve ushtarake ofensive, operacioneve defenzive, stabilitetit. Kursi është rezident dhe zhvillohet në Qendrën e Manovrave të Ekselencës të Ushtrisë Amerikane në Fort Benning Ga-SHBA-ve. Kapiten Rexhepi është dalluar me paraqitjen e tij të shkëlqyeshme, gjatë pjesëmarrjes në trajnimin „Kursi i kapitenit të karrierës–manovrave" në SHBA, me çka, nga stafi i lartë i Qendrës së Manovrave të Ekselencës të Ushtrisë Amerikane është nderuar me diplomë, mirënjohje dhe certifikatë.

Holanda i dhuron FSK-së donacion për kërkim-shpëtim



Prishtinë, 19 shkurt 2020. Në kazermën "Evropianët e Rinj" në Pomozotin, u mbajt ceremonia e pranimit të donacionit nga Qeveria e Holandës me pajisje malore–dimërore, donacion ky në vlerë rreth 25000 Euro, i cili iu dhurua Qendrës Ndërkombëtare Trajnuese të Kërkim- Shpëtimit (QNKTSH) të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Të pranishëm në ceremoni ishin edhe zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjeneral majori Enver Cikaqi, komandanti i Gardës Kombëtare, gjeneralmajori Xhevahir Geci, ambasadorja e Mbretërisë së Holandës, Gerrie Willems, atasheu i Holandës, Theo Plijner, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri, drejtori i QNKTSH-së, z. John Doone, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Zëvendëskomandanti i FSK-së, gjenerali Enver Cikaqi, pasi përshëndeti të pranishmit, vlerësoi lart bashkëpunimin mes Mbretërisë së Holandës dhe FSK-së, duke u shprehur: "Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë bazohet në memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Holandës, i cili daton që nga dhjetori i viti 2009. Qëllimi i këtij donacioni është ngritja e kapaciteteve të QNKTSH-së, për ta ndihmuar këtë qendër në rritjen e numrit të trajnerëve për zhvillimin e trajnimeve të reja. „Ndërsa, ambasadorja holandeze znj. Gerrie Willems, duke përgëzuar për punën dhe sukseset e deritanishme të kësaj qendre, uroi që sukseset e tilla të vazhdojnë edhe në të ardhmen, dhe shprehu bindjen që bashkëpunimi dhe ndihma nga Ambasada Holandeze nuk do të mungojnë as në të ardhmen. Në fjalën e tij, atasheu holandez i Mbrojtjes Theo Plijner, tha se dhurimi i këtij donacioni do t'iu ndihmojë pjesëtarëve të kërkim-shpëtimit dhe atyre të KDS-së në kryerjen e detyrave gjatë misionit të tyre. Ai po ashtu vlerësoi lart punën e pjesëtarëve të kërkim–shpëtimit gjatë tërmetit në Shqipëri, duke thënë se „ndjehet i sigurt se më këto pajisje ata do të tregohen edhe më të suksesshëm në përballje me fatkeqësi të tilla".

Një paraqitje të shkurtër rreth misionit të kësaj qendre, historikut, trajnimeve të realizuara gjatë vitit të fundit, trajnimeve që do të realizohen gjatë këtij viti, si dhe për vlerën e këtyre

FSK-ja i përgjigjet aksionit të dhurimit vullnetar të gjakut




Prishtinë, 18 shkurt 2020. Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes filloi aksioni tradicional për dhurimin vullnetar të gjakut. Ky aksion realizohet sipas planit vjetor të Departamentit për Çështje Mjekësore të MM-së në realizim të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe Regjimentit të Mjekësisë së FSK-së. Aksioni i filluar sot në MM do të vazhdojë në Shtabin e Përgjithshëm dhe në të gjitha njësitë e FSK-së deri më datën 07 shkurt 2020. Përkundër angazhimeve tjera, interesimi i stafit civil dhe ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes për dhurimin vullnetar të gjakut, që në ditën e parë ishte i madh. Kjo dëshmon se FSK-ja vazhdon traditën e organizimit të dhurimit vullnetar të gjakut. Pjesëtarët e FSK-së përveç dhurimit në formë të organizuar së paku dy herë në vit, gatishmërinë për dhurimin vullnetar të gjakut e shfaqin gjatë tërë vitit në rast të kërkesave të qytetarëve. Nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut vlerësohet se FSK-ja është dhuruesi më i madh i gjakut për qendrën e tyre. Sikur edhe viteve tjera, ku brenda vitit pjesëtarët e FSK-së kanë dhuruar mbi 1 mijë doza gjaku, pritet që ky aksion të përmbyllet suksesshëm.

Ministri Anton Quni vizitoi Komandën e Forcave Tokësore

Prishtinë, 26 shkurt 2020. Në vazhdën e vizitave në komandat kryesore të FSK-së, ministri i Mbrojtjes Anton Quni i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneralmajor Enver Cikaqi dhe stafi i tij, vizitoi Komandën e Forcave Tokësore në Istog. Ai u prit nga komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj dhe stafi i tij komando-shtabor. Në fillim, gjeneral Hadërgjonaj e falënderoi ministrin Quni për vizitën e tij dhe e uroi për detyrën e re, duke e njoftuar me të arriturat e deritashme të KFT-së, procesin e tranzicionit nëpër të cilin po kalojnë, sfidat dhe objektivat për të ardhmen. Me një prezantim të veçantë rreth misionit, strukturës organizative, personelit, trajnimeve, pajisjeve, kapaciteteve infrastrukturore, organizimit dhe funksionimit të brendshëm si dhe planit të tranzicionit të njësisë, ministrin Quni e njoftoi shefi i Shtabit të KFT-së, nënkolonel Shiqer Maloku. Pastaj, ministri Quni vizitën e vazhdoi në Regjimentin e Dytë të Këmbësorisë së Komandës së Forcave Tokësore, për të cilën u njoftua nga komandanti i saj nënkolonel Astrit Haliti. Para ministrit Quni, pjesëtarët e kësaj njësie demonstruan shkathtësitë e tyre taktike individuale dhe kolektive në skenarë dhe situata të ndryshme. Atij, gjithashtu iu prezantuan edhe pajisjet individuale të pjesëtarëve, krahas njoftimit me kapacitetet logjistike, teknike dhe infrastrukturore të saj. Ministri Quni, para stafit komandues e shtabor dhe pjesëtarëve pjesëmarrës në demonstrim, shprehu mbresën e tij për Komandën e Forcave Tokësore, duke i përgëzuar për shkallën e lartë të profesionalizimit, aftësive dhe kapaciteteve operacionale , si një garanci e fuqishme e nivelit të gatishmërisë operative për përmbushjen e misionit të saj. Në fund, ai siguroi se në cilësinë e ministrit të Mbrojtjes do të ofrojë të gjithë angazhimin, përkushtimin dhe mbështetjen e nevojshme për realizimin e planit të njësisë në kuadër të realizimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së, si synim parësor.

Komandanti i Forcave Tokësore gjenerali Fadil Hadergjonaj vizitoi FARSH-në në Shqipëri



Prishtinë, 20 shkurt 2020. Regjimenti I-rë i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) dhe strukturat e tij vartëse, në kuadër të bashkëpunimit me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), zhvilluan stërvitjen "Partnerët-20".Gjatë kësaj stërvitjeje komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, realizoi një vizitë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Tiranë, ku u mirëprit nga komandant i KDS-së Prof. Asoc. Bajram Begaj. Gjeneral Begaj e njoftoi komandantin e KFT- së me zhvillimet e fundit në institucionin e KDS-së, në veçanti me pjesën stërvitore të programeve të studiuara akademike dhe konkretizimin e tyre në stërvitjet e këtij lloji, siç është dhe stërvitja "Partnerët 20". Në takim të dy komandantët diskutuan për thëllimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit dypalësh mes FSK-së dhe FARSH-së, konkretisht në fushën e arsimimit dhe trajnimit ushtarak si dhe të stërvitjeve të llojit simulativ, nëpërmjet qendrës së simulimit, me interes të përbashkët të rritjes së kapaciteteve trajnuese. Ndërkaq, gjeneral Hadërgjonaj e falënderoi komandantin e KDS-së gjeneral Begajn për mikpritjen dhe për të gjitha informacionet, duke u shprehur se këto lloj stërvitjesh dhe bashkëpunimi në këtë fushë do t'i shërbejnë më së miri orientimit drejt zhvillimit të kapaciteteve trajnuese e stërvitore simuluese të FT/FSK-së". Stërvitja i ka kaluar të gjithë hapat e zhvillimit, që nga Konferenca e specifikimeve, duke nisur nga hapat fillestarë, kryesorë dhe finalë planifikues e deri te trajnimi i operatorëve për procesin e vendimmarrjes ushtarake si dhe për HICON/ EXCON. Gjithë procesi i planifikimit të stërvitjes, procesi i vendimmarrjes ushtarake dhe ai i ekzekutimit, janë zhvilluar sipas proceduarave standarde të NATO-s, bazuar në dokumentin kryesor COPD. Stërvitja kishte për qëllim aftësimin e Shtabit të Regjimentit të I-rë dhe strukturave të tij vartëse lidhur me procesin e planëzimit në nivel operacional, procedurën e vendimmarrjes ushtarake (MDMP) në nivel taktik dhe dinamikën e zhvillimit të luftimit, duke zbatuar konceptet doktrinare të NATO-s.

FSK-ja e dyta në garën „International Relay Competition"



Prishtinë, 16 shkurt 2020. Më 16 shkurt 2020, në organizim të KFOR-it, në Kampin „Film City" u mbajt gara „International Relay Competition"- Gara Ndërkombëtare e Stafetave. Në këtë garë morën pjesë 17 ekipe nga njësitet e KFOR-it, si dhe një ekip i Forcës së Sigurisë të Kosovës, ku secili ekip ka pasur 10 ushtarë, në mesin e tyre një femër. Garat u zhvilluan në „vrapim me bartje të stafetës në distancë të përgjithshme prej 13 kilometrave". Përkundër konkurrencës së fortë, ekipi i FSK-së zuri vendin e dytë, ku nga organizatori u shpërblye me medaljen e argjendtë. Ekipi i FSK-së përbehej nga OR-3 Alban Fazliu, OR-2 Bajram Zeneli, OR-2 Dardan Nuhaj, OR-2 Ejdon Mulaku, OR-4 Jasmin Zvarko, OR-2 Armend Neziraj, OR-2 Endrita Brahimi, OR-2 Mehdi Bala, OR-2 Zahir Mehmeti, OR-2 Visar Mehmeti, ndërsa OR-4 Ramadan Voca ishte udhëheqës i ekipit. Kjo ishte gara e parë e këtij niveli që është organizuar nga KFOR-i në Film City. Pjesëmarrja e FSK-së, në këtë ngjarje është reflektim i bashkëpunimit të shkëlqyeshëm mes FSK-së, KFOR-it dhe NALT-it.

Mbahen testimet e kandidatëve për Akademinë e Forcave Ajrore dhe Akademinë Ushtarake-West Point të SHBA-ve



Prishtinë, 18 shkurt 2020 - Në Forcën e Sigurisë së Kosovës janë duke u realizuar testimet për kandidatët me mundësi potenciale për të qenë pjesë e Akademisë së Forcave Ajrore dhe Akademisë Ushtarake-West Point në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Testet për rekrutë, si testi i inteligjencës, testi i gjuhës angleze dhe TOFEL, janë mbajtur në Ambasadën Amerikane, nën mbikëqyrjen e instruktorëve të FSK-së dhe atyre amerikanë. Pas testimeve, gjatë javës së kaluar, 9 kandidatët e mbetur në garë, të cilët arritën me sukses që t'i kalojnë fazat testuese të mëhershme, iu nënshtruan edhe testit të fundit, atij fizik, në kazermën Adem Jashari në Prishtinë. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen do të studiojnë në akademitë e lartpërmendura në SHBA, për 4 vite rresht, dhe më pas do të kthehen në Kosovë për të shërbyer në FSK. Shpresojmë që edhe këtë vit studentët tanë të tregojnë suksese, ashtu siç treguan dy vite më parë, Arilena Shala dhe Yll Dalladaku, studentët e parë nga Kosova në Akademinë Ushtarake-West Point.

FSK-ja mban trajnimin „Reagimi ndaj emergjencave natyrore" në shkollën fillore në Prizren




Prishtinë, 05 shkurt 2020. Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) të Qendrës Trajnuese Ndërkombëtare të Kërkim-Shpëtimit nga Garda Kombëtare, gjatë kësaj jave kanë realizuar trajnimin njëditor në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët „Abdyl Frashëri" në Prizren. Në këtë trajnim përveç mësimdhënësve morën pjesë edhe punëtorët teknikë dhe sigurimi i shkollës me qëllim të vetëdijesimit të tyre në rast të ndonjë fatkeqësisë natyrore. Rol i veçantë në trajnim iu kushtua reagimit ndaj tërmeteve, me ç 'rast u vendosën edhe shenja emergjente në dy objektet e shkollës. Në këtë shkollë aktualisht vijojnë mësimin rreth 2 mijë nxënës shqiptarë dhe të komunitetit turk dhe boshnjak. Ky trajnim është realizuar nga FSK-ja në bashkërendim me Kompaninë për Operacione me Civilë (KOC) dhe Ekipin Mbështetës Civilo-Ushtarak të Ambasadës Amerikane. KOC-i dhe FSK-ja angazhohen në realizimin e aktiviteteve me fokus të veçantë në përfshirjen e të gjitha komuniteteve.

Kadetët e QSU-së realizuan trajnimin „Kërkim-shpëtim në male”



Prishtinë, 18 shkurt 2020. Në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QNTKSH) në Pomozotin, kadetët e vitit të katërt të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, kanë përfunduar trajnimin „Kërkim-shpëtim në male dhe mbijetesa në dimër“ zhvilluar në terrene të hapura; me reshje të shumta të dëborës dhe temperatura të ulëta, e që ishin sfidë për stafin trajnues dhe kadetët, posaçërisht trajnimi gjatë netëve me mot të ftohtë dhe me ngrica. Qëllimi i mbajtjes së trajnimit me intensitet të lartë, ishte përgatitja e tyre në kryerjen e detyrave në male si dhe përshtatja për mbijetesë në kushte ekstreme të motit. Trajnimi është planifikuar dhe realizuar nga instruktorët e QSU-së dhe kishte karakter vlerësues. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit kanë mësuar teknikat e instalimeve me litar duke përfshirë nyjat dhe lidhjet; lëshimet nga kulla dhe nga lartësitë e larta, të ndryshme. Gjithashtu, kadetët kanë mësuar edhe ndërtimin e strehimoreve për mbijetesë me materialet e gjendura në natyrë, metodat e ndezjes së zjarrit, sigurimin e ujit dhe të ushqimit. Pjesëmarrësit e trajnimit janë përgatitur edhe për orientime në natyrë, pa harta dhe busulla, vetëm duke u orientuar përmes: diellit, hënës, yjeve dhe objekteve tjera në natyrë. Finalizimi i kursit ishte marshimi i pjesëmarrësve në gjatësi mbi 8 km, qëndrimi në natyrë mbi 40 orë dhe zbatimi në praktikë i mësimeve të mësuara.



Ekspertët amerikanë trajnojnë pjesëtarët e FSK-së në fushën e mjekësisë



Prishtinë, 27 janar 2020. Në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë u realizuar punëtoria njëjavore „Role 1 Medical Operations Development Workshop“, nga ekipi i ekspertëve amerikanë për pjesëtarët e Regjimentit të Mjekësisë të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Punëtoria është ndarë në pjesën teorike dhe atë praktike, ku janë realizuar tema të ndryshme duke filluar nga: Ndihma e parë në fushëbetejë, procedurat standarde operative specifike dhe të përgjithshme, procesi i alarmimit të stafit mjekësor, evakuimi mjekësor e të tjera. Në këtë punëtori, të zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh të FSK-së me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 21 pjesëtarë të Regjimentit të Mjekësisë përfituan nga përvojat e shumta të trajnerëve amerikanë.

„Mbijetesa në kushte dimërore“ ushtrim i suksesshëm i kadetëve të FSK-së



Prishtinë, 06 shkurt 2020. Në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QNTKSH) në Pomozotin, është realizuar trajnimi „Mbijetesa në kushte dimërore“ një trajnim mjaft sfidues dhe i veçantë për përgatitjen e personelit për mbijetesë në kushte ekstreme të motit. Qëllimi i mbajtjes së trajnimit ishte përgatitja e tyre në kryerjen e detyrave në male si dhe përshtatja për mbijetesë në kushte ekstreme të motit të ftohtë. Ky trajnim është realizuar nga instruktorët e QNTKSH-së, dhe është zhvilluar në mjedise të hapura dhe në temperatura të ulëta gjatë netëve dhe ditëve. Gjatë trajnimit pjesëtarët e FSK-së, kanë mësuar për ndërtimin e strehimoreve për mbijetesë me materialet e gjendura në natyrë, metodat e ndezjes së zjarrit, sigurimin e ujit dhe të ushqimit. Pjesëmarrësit gjatë trajnimit janë përgatitur dhe për orientime në natyrë, pa harta dhe pa busulla.

Përmbyllet me sukses trajnimi bazik në Qendrën e Kërkim-Shpëtimit Urban të FSK-së

Prishtinë, 18 shkurt 2020. Në Qendrën Ndërkombëtare Trajnuese për Kërkim- Shpëtim në Pomozotin ka përfunduar trajnimi i nivelit bazik për kërkim -shpëtim urban. Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë përgatitja e pjesëmarrësve lidhur me reagimin në rast të krizave të ndryshme humanitare. Gjatë këtij trajnimi, nga instruktorët e



QNTKSH-së janë ligjëruar tema të ndryshme nga fusha e kërkim-shpëtimit urban në nivel bazik, siç janë: siguria në operacion, metodat e kërkimit, vlerësimi i objekteve, pesë fazat e shpëtimit, ndihma mjekësore në katastrofa urbane, përdorimi i pajisjeve të posaçme dhe përdorimi i litarëve. Trajnimi është zhvilluar në objektet e kazermës së Gardës Kombëtare, përkatësisht në poligonin e Qendrës Ndërkombëtare Trajnuese për Kërkim- Shpëtim. Pjesëtarët të cilët përfunduan nivelin bazikë të kërkim –shpëtimit urban, në të ardhmen do të kualifikohen për të vijuar edhe nivelin e avancuar, i cili po ashtu do të realizohet nga QNTKSH-ja.

FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 89 • 4 Maj 2020 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Ministri Anton Quni priti ambasadorin e SHBA-ve, Philip Kosnett



Prishtinë, 13 Mars 2020. - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, priti sot ambasadorin e SHBA-së në Kosovë, Philip Kosnett duke i uruar mirëseardhje dhe shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për SHBA-në në mbështetjen e pazëvendësueshme të ofruar deri më tani në të gjitha periudhat historike të vendit dhe popullit tonë si dhe në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e gjithmbarshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ministri Quni theksoi se mbështetja e deritashme në trajnime, shkollime, mbështetje logjistike dhe forma tjera e ofruar nga SHBA ka qenë jetike në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e kuadrove profesionale dhe ndikim të lartë në realizimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale kompatibile dhe interoperabile me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-së dhe vet forcat ushtarake amerikane. Ai shprehu gatishmërinë dhe vullnetin e plotë që FSK me njësitë e saj të angazhohet në operacionet paqeruajtëse bashkë me forcat amerikane. Ministri Quni e njoftoi ambasadorin Kosnett edhe me procesin e implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit duke ritheksuar se ky proces, si deri më tani, do të realizohet në transparencë të plotë dhe përputhje me kornizën kohore të planifikuar si dhe në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me vendet partnere e posaçërisht me SHBA-në. Ai ritheksoi edhe njëherë se FSK është dhe do të jetë forcë bashkëkohore me vlera dhe standarde të vendeve të NATO-s nën kontrollin civil demokratik dhe gjithnjë në shërbim të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë. Nga ana e tij, ambasadori Kosnett, premtoi se SHBA, përmes Programit Shtetëror të Partnershipit me Gardën Kombëtare të Ajovës dhe programeve tjera, sikur edhe deri më tash, do të vazhdojë partneritetin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në mënyrë që të përmbushë me sukses të plotë synimet e tyre, respektivisht procesin e tranzicionit sipas planit përkatës. Ambasadori Kosnett, ndër tjera shprehu edhe interesimin për projektin e shërbimit të obligueshëm ushtarak, për të cilin, ministri Quni e informoi nga këndvështrimi profesional duke theksuar rëndësinë e këtij projekti; nga dimensioni edukativ, arsimor, social, ndërkomunikues, integrues dhe kultivimin e vlerave të mëdha që ka diversiteti kulturor, etnik dhe fetar i vendit për gjeneratat e reja. Ai, në fund theksoi se ky projekt, tanimë është pjesë e programit qeverisës dhe do të analizohet dhe vlerësohet nga ekspertë të të gjitha fushave nga institucionet akademike, institucionet ndërkombëtare, shoqëria civile, organizata të ekspertëve dhe strukturat profesionale tona ushtarake gjithnjë në transparencë dhe bashkërendim të plotë me partnerët tanë. Ky projekt, shtoi ai, nuk e cenon procesin e tranzicionit dhe statusin e FSK-së si forcë profesionale. Në fund, të dy ishin të një qëndrimi që të intensifikohet edhe më tej bashkëpunimi bilateral në mes dy vendeve mike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Në delegacionin pritës të Ministrit Quni ishin shefi i Kabinetit të ministrit Jashar Ramadani, këshilltari ushtarak Kolonel Hamdi Pollomi, kurse ambasadori Kosnett shoqërohej nga atasheu ushtarak i SHBA-së në Kosovë, kolonel Rayan Nicols dhe zyrtari politik, Chris Dittmeir.

Presidenti Hashim Thaçi vizitoi Qendrën Mjekësore të FSK-së



Prishtinë, 26 Mars 2020. Në kuadër të gjendjes emergjente të krijuar nga përhapja e pandemisë edhe në vendin tonë nga virusi COVID-19, presidentit i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, vizitoi sot Qendrën Mjekësore të Forcës së Sigurisë të Kosovës në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë. Në ambientet e Qendrës Mjekësore, presidenti u prit nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe drejtori i kësaj qendre, dr. Shkëlzen Sylaj. Gjatë vizitës, presidenti Thaçi, u njoftua nga drejtori Sylaj, me kapacitet që ka kjo qendër, stafin profesional, kapacitetet teknike dhe hapësinore, që janë në gatishmëri për t' ju dalë në ndihmë qytetarëve, në rast të nevojës nga një përshkallëzim i gjendjes së epidemisë në vendin tonë. Presidenti Thaçi, shprehu kënaqësinë me përgatitjet e bëra, nivelin e gatishmërisë dhe profesionalizmin e pjesëtarëve të FSK-së, të treguar komforë situatës së krijuar. Presidenti dhe Komandanti i FSK-së, në mesazhin e përbashkët drejtuar qytetarëve të vendit, kërkojnë; që të qëndrojnë në shtëpi, dhe t'u përmbahen udhëzimeve të lëshuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Vizita e Komandantit të FSK-së, në Republikën e Maqedonisë së Veriut



Shkup, 02 Mars 2020. - Sot, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama qëndroi për vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komandanti i FSK-së, në Komandën e Ushtrisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut u prit me ceremoni ushtarake. Gjatë vizitës, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, fillimisht u prit në takim nga ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Radmila Shekerinska e cila shoqërohej nga drejtori i Shtabit të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjeneral majori Zoran Milevski. Gjatë takimit të përbashkët të gjeneral Ramës dhe ministres Shekirinska u bisedua për marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimin e suksesshëm në mes dy ministrive. Komandanti i FSK-së, në Komandën e Ushtrisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut u pritë nga shefi i Shtabit të Ushtrisë së Republikës të Maqedonisë së Veriut, gjenerallejtënant Vasko Gjurqinovski. Pas pritjes protokollare të dy gjeneralët zhvilluan një takim pune kokë me kokë. Po ashtu, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama u pritë në takim edhe nga presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, i cili shoqërohej nga shefi i Shtabit të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjenerallejtënant Vasko Gjurqinovski, kurse komandanti i FSK-së, gjeneral Rama shoqërohej nga zëvendës ambasadori i Republikës së Kosovës në Maqedoni, Flurim Gashi. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, në fund vizitoi edhe Akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihajlo Apostolski", ku u takua me kadetë të FSK-së, të komuniteteve pakicë që studiojnë pa barriera gjuhësore në këtë akademi. Nga zëvendës shefi Shtabit të Ushtrisë së Maqedonisë së Veriut, gjeneral majori Azin Nuredini u njoftua për kadetët e FSK-së, për nivelin e angazhimeve të tyre, si dhe për sukseset e treguara. Vizita e sotme e komandantit të FSK-së, dëshmoi edhe një herë bashkëpunimin e mirë të deritashëm në mes të dy ushtrive. Po ashtu gjatë takimeve të sotme u bisedua edhe për mundësitë e thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit në të ardhmen në mes të ushtrive të shteteve tona, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës.

Ministri Anton Quni priti në vizitë pune ambasadoren e Francës



Prishtinë, 11 Mars 2020. Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, në vazhdën e vizitave të ambasadorëve të vendeve mike, priti sot në Ministrinë e Mbrojtjes, ambasadoren e Republikës së Francës në Kosovë, Marie Christine Butel. Me këtë rast, ministri Quni falënderoi ambasadoren Butel, për vizitën e saj dhe shprehu falënderimin për Republikën e Francës, si vend mik, në mbështetjen e ofruar vendit tonë deri më tani në të gjitha fushat, duke theksuar rolin e saj në sigurinë e përgjithshme, në vitet e rindërtimit dhe zhvillimit të vendit me kontingjentin ushtarak të KFOR-it. Ministri Quni, theksoi rëndësinë e madhe që ka finalizimi i procesit të nisur për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes të Francës, duke pasur parasysh përvojën e madhe të forcave ushtarake franceze në përgjithësi, dhe në realizimin e suksesshëm të operacione paqeruajtëse në veçanti, me kërkesën edhe për këshillëdhënie profesionale ushtarake. „Pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse është ndër detyrat kryesore ligjore të FSK-së, andaj edhe synim yni është zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve operacionale kompatibile dhe të ndërveprueshme me forcat e vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s. Ky synim do të kurorëzohet me ofrimin e mundësisë për ofrimin e kontributit tonë në kuadër të forcave shumëkombëshe për paqen, stabilitetin dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë“ tha ai.Nga ana e saj, ambasadorja Butel, uroi ministrin Quni, për marrjen e detyrës së ministrit të mbrojtjes duke njoftuar për interesimin e Francës për zhvillimet në FSK, dhe procesin e tranzicionit të saj. Ajo shprehu gatishmërinë e shtetit francez, që përmes ministrisë së saj të mbrojtjes dhe atasheve ushtarakë respektiv, ndërmjet dy vendeve të thellojnë kontaktet me diskutimin përmbajtjesor të temave me interes të përbashkët deri në nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit bilateral. Ambasadorja Butel, ndër tjera shprehu edhe interesimin për projektin e shërbimit të obligueshëm ushtarak, për të cilin, ministri Quni e informoi nga këndvështrimi profesional duke theksuar rëndësinë e këtij projekti; nga dimensioni edukativ, arsimor, social, ndërkomunikues, integrues dhe kultivimin e vlerave të mëdha që ka diversiteti kulturor, etnik dhe fetar i vendit për gjeneratat e reja. Ai, në fund theksoi se ky projekt, tanimë është pjesë e programit qeverisës dhe do të analizohet dhe vlerësohet nga ekspertë të të gjitha fushave nga institucionet akademike, institucionet ndërkombëtare, shoqëria civile, organizata të ekspertëve dhe strukturat profesionale tona ushtarake gjithnjë në transparencë dhe bashkërendim të plotë me partnerët tanë. Nga ana e saj, ambasadorja Butel, premtoi se Republika e Francës do të vazhdojë bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, dhe bashkë me ministrin Quni u dakorduan që të arrihet marrëveshja e bashkëpunimit bilateral me interes në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së përgjithshme. Në delegacionin pritës të ministrit Quni, ishin shefi i Kabinetit të Ministrit, Jashar Ramadani, këshilltari ushtarak kolonel Hamdi Pollomi dhe zyrtarja e lartë e kabinetit të Ministrit, Martina Dedaj-Kqira, kurse ambasadorja Butel, shoqërohej nga atasheu ushtarak i Francës për Kosovë, kolonel Fabricie Duda.

Enver Dugolli emërohet Zëvendësministër i Mbrojtjes



Prishtinë, 18 Mars 2020. Sipas vendimit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, sot, pranoi detyrën e zëvendës ministrit të mbrojtjes, ish-veprimtari i çështjes kombëtare, ish-oficeri i TMK-së dhe FSK-së, si dhe ish-atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, gjeneral brigade në pension Enver Dugolli. Me këtë rast, zëvendës ministrit Dugolli i dëshiruan mirëseardhje Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe Shefi i Kabinetit të Ministrit , Jashar Ramadani. Bazuar në përvojën e gjatë profesionale ushtarake në detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme, në proceset nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon Ministria e Mbrojtjes dhe FSK, roli dhe kontributi i zëvendësministrit Dugolli do të jetë me rëndësi të veçantë.

Komandanti i Gardës Kombëtare priti në takim drejtorin e NALT-it



Prishtinë, 11 Mars 2020. Komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Xhevahir Geci ka pritur sot në takim drejtorin e NALT-it, gjeneral brigade Michael Oberneyer, të shoqëruar nga koloneli amerikan Jeffrey Eget. Së pari gjeneral Geci e njoftoi drejtorin e NALT-it lidhur me organizimin e Gardës Kombëtare, aktivitetet e njësive të saj, si dhe sukseset dhe sfidat me të cilat po përballet. Më pas, të dy gjeneralët biseduan për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit të FSK-së me NALT-in. Komandanti i Gardës Kombëtare shprehu mirënjohjen e tij të thellë për mbështetjen ndër vite të FSK-së nga NALT-i. Gjithashtu, gjeneral Oberneyer e përgëzoi gjeneral Gecin për profesionalizmin e pjesëtarëve të njësisë së Gardës Kombëtare duke thënë: “Ju përgëzoj për operacionin në Shqipëri, ekipet e juaja të kërkim-shpëtimit, të cilat kanë qenë në nivel të detyrës duke treguar profesionalizëm të lartë. Ju siguroj që NALT do të vazhdojë përkrahjen dhe bashkëpunimin. Në fund, të dy gjeneralët u pajtuan që bashkëpunimi i NALT-it me FSK-në të vazhdohet duke u ngritur në nivel edhe më të lartë.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma “Adem Jashari”, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Nënoficerët e Ushtrisë Amerikane për Evropë vizitojnë FSK-në



Prishtinë, 04 Mars 2020. Në Ministri të Mbrojtjes dhe në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së në Ferizaj, dje qëndroi për vizitë pune, komandanti i Akademisë së 7-të të nënoficerëve të Ushtrisë Amerikane për Evropë, rreshter major i Komandës, Christopher Cascardo, së bashku me një delegacion të nënoficerëve. Rreshter majori Cascardo, në Ministri u prit nga rreshter majori i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) Genc Metaj. Kjo ishte një vizitë bashkërenduese për bashkëpunimin në të ardhmen në mes të FSK-së dhe Akademisë së 7-të të nënoficerëve. Rreshter majori Cascardo, gjithashtu vizitoi edhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, ku u pritën dhe zhvilluan takim pune me rreshter majorin e Komandës, Xhevdet Mataj dhe me komandantin e Shkollës se nënoficerëve të FSK-së, rreshter majorin Ilir Ferizaj. Rreshter majorët Mataj dhe Ferizaj e njoftuan RRMK Cascardo, me të arriturat e FSK-së në zhvillimin e sistemit të edukimit të nënoficerëve. Të dy palët u pajtuan për avancimin e mëtejmë të programeve të bashkëpunimit dhe mundësinë e shkëmbimit të nënoficerëve dhe përvojave. Vlen të ceket se që nga fillimi i formimit të sistemit të edukimit të nënoficerëve të FSK-së, Akademia e 7-të e nënoficerëve ka pasur rol shumë të rëndësishëm në këtë zhvillim.

FSK-ja mbajti konferencën „Fuqizimi i gruas në institucione dhe roli i saj në zhvillimin e shtetit“



Prishtinë, 8 Mars 2020. - Me rastin e shënimit të 8 marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, ka mbajtur sot konferencën me temën: „Fuqizimi i gruas në institucione dhe roli i saj në zhvillimin e shtetit“. Panelistët e kësaj konferencë ishin: Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, znj. Vjosa Osmani, nënkolonel Remizie Zeqiraj nga Forca e Sigurisë së Kosovës, nënkolonel Zylfije Krasniqi nga Policia e Kosovës dhe znj. Deb MacLean, përfaqësuese nga ambasada e SHBA-ve, në Prishtinë. Me një prezantim të shkurtër për 8 marsin dhe panelistët, konferencën e hapi kapiten Mimoza Budeci nga FSK-ja, për t'i lenë radhën më pas punimeve të kësaj konference. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, znj. Vjosa Osmani, pasi përshëndeti pjesëtarët e FSK-së, Policisë së Kosovës, Shërbimit Korrektues dhe të gjithë të pranishmit, tha se synimi ynë sot, nuk është që të festojmë, por të flasim për të gjitha sfidat që na rrethojnë. „Me fuqizimin e gruas duhet të nënkuptojmë promovimin e mëtejmë të rolit të saj në shoqëri. Ne do të duhet të ndihemi të kënaqura me rolin tonë, në qoftë se pozicioni publik të cilin e mbajmë, na ka mundësuar që në radhë të parë të ngritëm zërin për problemet me të cilat, sot ballafaqohemi, dhe së dyti të mos mbetet vetëm zë, apo letër, por të ndermirën veprime konkrete që përmirësojnë rolin dhe pozicionin e gruas në shoqëri. E them me shumë bindje, që nuk ka profesion në të cilin gratë nuk mund të shkëlqejnë. Ju e dëshmoni atë në fushën e Sigurisë, ndërsa vajzat si; Majlinda Kelmendi e Distria Krasniqi dhe të tjerat e dëshmojnë në fushën e sportit. Kemi vajza dhe gra të jashtëzakonshme, që po e dëshmojnë këtë dita-ditës në fusha të ndryshme. Në fund i porosis të gjitha femrat dhe gratë që mos të dorëzohen nga fjalë dhe gurët që gjuhen në drejtim tonin, por me ta, të vazhdojmë të ngremë kështjella të fuqishme ".Ndërsa, nënkolonel Remzie Zeqiraj, (FSK) fjalimin e saj e fokusoi në tri etapa: „Roli i femrës në të kaluarën, pozita aktuale që mban femra sot në institucionin tonë dhe perspektiva në të ardhmen“. „Sot në këtë ditë, ne në Kosovë, kemi zemrën plotë me marrshin e lirisë, marshin e „Epopesë së UCK-së“, prandaj trëndafilat që i marrim në këtë ditë, simbolikisht ua dedikojmë gjithë atyre grave që ranë heroikisht kudo në Kosovë. Filet e angazhimit të grave në ushtri i kemi historikisht të hershme ne si komb, por, edhe të prekshme me historinë e fundit. Rrëfimi për gratë ushtarake në Kosovë, është i njëjtë me rrëfimin e ngritjes së ushtrisë së Kosovës, që nga themelet e para e deri me sot. Gratë në Forcën e Sigurisë së Kosovës; arsimohen, trajnohen dhe stërviten sot në kohë paqeje, edhe pse, misioni i një ushtarakeje duket paksa më i lehtë, secila nga ne është rekrutuar, shkollohet dhe trajnohet për realizimin e misionit dhe kryerjes së detyrave me nder, me sfidueset që obligon uniforma ushtarake brenda së cilës, një ditë mund të japësh edhe frymën e fundit, për çka, ne kemi dhënë edhe betimin. „Kurse, panelistja nga Policia e Kosovës, nënkolonel Zylfije Krasniqi, foli për pjesëmarrjen e grave në Policinë e Kosovës dhe në institucione të sigurisë, ku nder të tjera, tha: „Kosova si shtet është liderë e përfaqësimit të femrës në të gjitha strukturat e Policisë së Kosovës, pasi në këtë aspekt qëndrojmë më së miri në përfaqësimin e femrave në rajon dhe më gjerë. Andaj ne duhet të angazhohemi dhe të jemi model i gjeneratave të reja për përfshirjen e grave në sektorin e Sigurisë, në veçanti, dhe në të gjitha fushat e jetës në Kosovë“. Zonja Deb MacLean, përfaqësuese nga ambasada e SHBA-ve, shprehu kënaqësinë e saj, që është pjesë e kësaj konference, dhe foli për rolin dhe rëndësinë e femrës në institucione. „Pjesëmarrja e grave në institucione të sigurisë është mjaft e rëndësishme, pasi që ushtaraket kanë dëshmuar shumë herë që janë të zonjat dhe të afta, po aq sa burrat, dhe meritojnë përfaqësim të barabartë në të gjitha institucionet. "Kjo konferencë kishte për qëllim sensibilizimin dhe fuqizimin e gruas në institucione, e në veçanti në institucionet e sigurisë dhe vendimmarrjes.

Në Ministrinë e Mbrojtjes u shënua 8 marsi - Dita Ndërkombëtare e Gruas



Prishtinë, 08 Mars 2020. - Sot, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, nën organizimin e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore të Ministrisë së Mbrojtjes u mbajt ceremoni festive me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Në sallën e mbushur plot me gra dhe vajza që shërbejnë si zyrtare dhe ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes në një atmosferë festive morën pjesë, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe Ud. sekretari i përgjithshëm, Faruk Geci. Hapjen e takimit solemn e bëri shefja e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore, Halime Morina, e cila në fjalimin e saj rikujtoi normat, parimet dhe vlerat fondamentale që përkojnë me këtë festë si dhe promovimin e tyre në shoqërinë, institucionet dhe vet Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në fjalën e tij, me këtë rast, ministri Quni, shprehu vlerësimin e lartë për rolin e pazëvendësueshëm të nënës, gruas, motrës e bijës në të gjitha periudhat historike dhe të dhënë në të gjitha dimensionet e familjes, shoqërisë në kauzën tonë për liri, pavarësi dhe demokraci. Ndër të tjera, ministri Quni, vlerësoi lart rolin dhe kontributin shumë të rëndësishëm dhe të pandarë të grave dhe vajzave , qoftë si nëpunëse civile apo ushtarake, për të gjitha të arriturat e deritashme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK. "Në ditët e sotme, gruaja kryeparlamentare, gjeneralë të FSK-së, si ju zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dëshmon fuqishëm se ju jeni shumë të suksesshme si në përgjegjësitë familjare ashtu edhe në ato institucionale e shtetërore". Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, uroi dhe shprehu mirënjohjen e thellë për angazhimin e dhënë, punën me përkushtim vetëmohues dhe shërbimin e shquar të të gjitha grave dhe vajzave, ushtarake e nëpunëse civile në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK, në funksion të ndërtimit, zhvillimit dhe të arriturave të deritashme të FSK-së, në përmbushjen e misionit të saj në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve të vendit. Në mbyllje të këtij aktiviteti, ministri Quni, gjeneral Rama dhe sekretari Geci u dhuruan lule grave dhe vajzave pjesëmarrëse.

FORCA JONË

FSK-ja shënoi 22 - vjetorin e



Prishtinë, 05 Mars 2020. Në Kazermën „Adem Jashari“ të Forcës së Sigurisë të Kosovës, dhe nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, sot u mbajt manifestimi qendror në shënimin e 22-vjetorit të Epopesë së UÇK-së, në nderim të Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit të rënë për liri. Në këtë ceremoni trupat e Ushtrisë së Kosovës (FSK) ishin të rreshtuara në kuadrate sipas njësive, në pistën e kazermës „Adem Jashari“ në Prishtinë. Të pranishëm në manifestim ishin presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentarja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, ish-presidentja Jahjaga, ish kryeministri Haradinaj, ministra, deputet, kryetar komunash, veteranë, invalidë, familjarë të dëshmorëve, qytetarë dhe nxënës të shkollave të Kosovës. Pas revistës së kuadrateve të FSK-së, nga presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, manifestimi filloi me intonimin e himnit shtetëror dhe kombëtar. Pastaj, presidenti Thaçi, kryeministri Kurti, kryetarja e Kuvendit Osmani, vendosen kurora lulesh pranë Obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri. Para të pranishmeve, në manifestimin e njëzetë e dy vjetorit të Epopesë së UÇK-së, presidenti Hashim Thaçi, në fjalën e tij, pos tjerash tha: „Të dashur ushtarë të ushtrisë të Republikës së Kosovës, ju jeni trashëgimtarë të projektit më të suksesshëm politik dhe ushtarak të Kombit shqiptarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të këtij projekti të shenjtë. Me luftën heroike të UÇK-së, të popullit të Kosovës dhe ndihmën e botës demokratike u çlirua edhe u bë shtet i pavarur dhe demokratik. Të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë; qytetaret dhe shteti ynë krenohet me ju, dhe me rezultatet e juaja kudo që shërbeni në çdo cep të Republikës së Kosovës. Ju jeni krenaria jonë, ju jeni ushtria moderne, bashkëkohore, jeni ushtri multietnike, ju do të pajiseni me pajisje me moderne të një ushtrie bashkëkohore, ky edhe ishte mesazhi gjatë diskutimit tim në Penta-







„Epopesë së UÇK-së“





gon“. Ndërsa, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalën e saj, adresuar të pranishmeve tha se sakrifica e familjes Jashari tregoi se sa e rëndësishme është liria, dhe se tani me dhembje e krenari kujtohet komandantin Adem Jashari, Hamëz Jashari, Shaban Jashari e të gjithë ata ushtarë që lanë jetën dhe gjymtyrët e tyre për lirinë që sot e gëzojmë. Kryetarja Osmani, më tej shtoi se; Kosova asnjëherë nuk ka pasur synime ndaj të tjerëve, por se „qëllimi ynë ka qenë vetëm mbrojtja e atdheut tonë. Sot secili kadetë, ushtarë e oficer duhet ta ketë parasysh sovranitetin e vendit, njësoj sikurse komandanti Adem Jashari. Ai dha shembullin se si mbrohet atdheu e duke u shndërruar në simbol të rezistencës“. Kurse kryeministri i Kosovës Albin Kurti, në fjalën e tij, pos tjerash tha: „Është çdoherë kënaqësi të jesh në prani të Forcës së Sigurisë së Kosovës e sidomos në këto ditë të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne kemi sakrifikuar shumë që të kemi të drejtat dhe liritë tona, të kemi shtetin tonë, por sidomos të kemi ushtrinë tonë, të fortë e madhështore, jo sepse ne kemi ambicie për të pushtuar, por për shkak se kemi të kaluar të hidhur. Ne duam një ushtri të fortë, profesionale e cila mbron tërësinë tonë territoriale dhe garanton sigurinë tonë kombëtare; duam anëtarësim në NATO, prandaj edhe do të rrisim investimet të cilat janë të domosdoshme që të bëhemi partnerë të denjë. Aleanca jonë me NATO-n është e domosdoshme dhe anëtarësimi ynë edhe në NATO edhe në BE duhet përshpejtuar në mënyrë që edhe të forcojmë paqen në rajon, por edhe të parandalojmë ndikimin e fuqive të huaja“. Në emër të familjes Jashai, foli vëllai i komandantit legjendar Adem Jasharit, Rifat Jashari, i cili nga Kazerma „Adem Jashari“, falënderoi të pranishmit dhe tha se vetë prezenca juaj, në këtë manifestim nderon dhe përkujton veprën e Adem Jasharit dhe të gjithë dëshmorëve të rënëve për liri. Manifestimi i Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u përmbyll me parakalimin e kuadrateve të FSK-së, para qytetarëve të pranishëm në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë.

Homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz në nderim të „Epopesë së UÇK-së“



Prekaz, 6 Mars 2020. - Në kuadër të manifestimit shtetëror tradicional „Epopeja e UÇK-së“, që mbahet me rastin e 22 vjetorit të rënies heroike të familjes Jashari, Komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për liri, sot ministri i Mbrojtjes Anton Quni dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, të shoqëruar nga zyrtarë të lartë të ministrisë, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-ë, së bashku me delegacionin shtetëror të kryesuar nga krye parlamentarja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, të shoqëruar nga zëvendëskryeministrat, ministrat dhe zyrtarë të lartë shtetëror, bënë homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz, pranë varrit të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të dëshmorëve tjerë të rënë për liri. Pas homazheve ky delegacion u pritë në familjen Jashari, nga kryefamiljari Rifat Jashari.

Ministri Anton Quni njoftohet për nivelin e gatishmërisë operacionale të FSK-së

Prishtinë, 17 Mars 2020. Pas situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, Forca e Sigurisë së Kosovës ka ngritur nivelin e gatishmërisë operacionale për mbështetje ushtarake të autoriteteve civile. Me qëllim të informimit sa më të afërt, sot në kazermat "Adem Jashari" në Prishtinë dhe në Pomazatin, Ministri i Mbrojtjes Anton Quni i shoqëruar nga Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shefi i Stafit të SHP të FSK-së, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, ka vizituar Qendrën



Operacionale të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së dhe njësitet e angazhuara në Forcën për Detyrë si njësitë për mbështetje logjistike, mbështetje mjekësore, xhenierie, mbrojtjes kimike, atomike dhe biologjike, policisë ushtarake, operacioneve civile dhe komunikimit. Nga ana e oficerëve përgjegjës të qendrës operative dhe njësive përkatëse, Ministri Quni u njoftua me planin e gatishmërisë, veprimet e deritashme si dhe kapacitetet njerëzore specialistike, profesionale, teknike, materiale dhe mbështetjes logjistike të Forcës për Detyrë, të cilat janë vënë në gatishmëri për veprim përballë situatës së krijuar. Ministri Quni shprehu vlerësimin e lartë për nivelin e gatishmërisë së FSK-së për reagim, me besimin e plotë se FSK edhe në këto rrethana të jashtëzakonshme do të arrijë me sukses të përmbushë detyrën kushtetuese dhe ligjore në mbështetje ushtarake të autoriteteve civile dhe qytetarëve tanë.

Zyrtarë të Ministrisë dhe oficerë të FSK-së në seminarin „Forcat e Armatosura në Demokraci" të mbajtur në Berlin

Berlin, 03 Mars 2020. - Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm në mes të Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë, një grup zyrtarësh të Ministrisë së Mbrojtjes dhe oficerë të lartë të FSK-së, qëndruar në një seminar një javor (25-28.02.2020) në Berlin të quajtur "Forcat e Armatosura në Demokraci". Seminari është organizuar nga "Qendra për Udhëheqje të Brendshme" e Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë (Bundesver). Bazuar në programin e seminarit pjesëmarrësit fillimisht janë njohur me "Bazat e filozofisë së menaxhimit të Bundesverit", ku ishin të përmbledhura konceptet dhe praktikat e mënyrave të qasjes së integrimit në shoqëri të "qytetarit në uniformë" dhe



në përgjithësi integrimit të forcave të armatosura sipas ligjeve dhe kushtetutës së vendit. Me interes të posaçëm ishte vizita në Komitetin e Mbrojtjes të Parlamentit të Gjermanisë, ku u bë një bashkëbisedim me deputetët Ekhard Gnotke dhe Aleksander Myller, të cilët për mes pyetjeve të shumta shprehen interesimin për proceset e transformimit të FSK-së në kuadër të misionit të ri, praninë e komuniteteve pakicë, sfidat dhe perspektivën në të ardhmen. Po ashtu u shpreh interesim dhe gatishmëri për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit më të thelluar në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë. Po ashtu vizita në Zyrën e Komisionerit Ushtarak në Parlamentin e Gjermanisë (Bundestag), ishte mundësi e mirë për tu njohur me rolin dhe detyrat e Komisionerit (Ombus personit ushtarak) si pjesë e Bundestagut, përvojën e deritashme, efikasitetin që ka treguar në punën e vet, efektet që janë dhënë për shoqërinë dhe posaçërisht ndihma e dhënë për "qytetarët në uniformë", ushtarakët aktiv profesionist dhe në rezervë. Ishte mundësi e mirë njohja me sistemin e punës dhe funksionimit të Këshillit Federal të Gjermanisë ku shprehen interesat e njësive federale (landeve) dhe harmonizimit të punës së këtij këshilli me parlamentin (Bundestagun) e vendit. Në kuadër të agjendës së përgatitur, grupi i pjesëmarrësve në seminar nga Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, janë pritur edhe në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin, nga ambasadori Beqë Cufaj dhe atasheu i Mbrojtjes, kolonel Xhavit Sadrijaj. Për mbarëvajtjen e këtij seminari në mënyrë sa më të këndshme dhe efektive, angazhim të pakursyer ka dhënë mikpritësi dhe drejtuesi i seminarit kolonel Martin Gerster dhe kolonel Xhavit Sadrijaj, atashe ushtarak në ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin.

Ministri Anton Quni vizitoi Regjimentin e Tretë të Forcave Tokësore



Prishtinë, 18 Mars 2020. Pas situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19 dhe me qëllim të informimit nga afër me nivelin e gatishmërisë operacionale të njësiteve të angazhuara në Forcën për Detyrë, sot ministri Quni me stafin e tij dhe i shoqëruar nga zëvendës komandanti i FSK-së gjeneralmajor Enver Cikaqi dhe komandanti i KFT-së gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj ka vizituar Regjimentin e Tretë të Forcave Tokësore në Mitrovicë. Me këtë rast, nga ana e zëvendës komandantit të Regjimentit të Tretë, Nënkolonel Avni Kiçina, Ministri Quni u njoftua me planin e gatishmërisë, nivelin e koordinimit me komandën superiore, veprimet e deritashme si dhe nivelin e gatishmërisë së kapaciteteve njerëzore specialistike, materiale, teknike dhe mbështetjes logjistike të regjimentit përkatës. Ministri Quni shprehu vlerësimin e lartë për njësinë përkatëse dhe inkurajoi pjesëtarët e saj për përgatitjet e duhura, motivin dhe moralin e lartë të dëshmuar si gjithmonë mbështetjen e plotë ushtarake të autoriteteve civile dhe qytetarëve tanë në përballje me sfidën aktuale që po kalojmë. Në këtë rrethanë të jashtëzakonshme, ku është me rëndësi jetike shëndeti i qytetarëve, ministri Quni theksoi domosdoshmërinë që FSK, të jetë e gatshme të iu shërbej të gjithë qytetarëve pa dallime etnike dhe gjithmonë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me KFOR-in. Menaxhimi me sukses i kësaj situate është edhe një provë konkrete se FSK dhe Kosova po tregojnë pjekurinë e duhur institucionale dhe shtetërore që të jenë pjesë e NATO-s.

Ministri Anton Quni vizitoi Regjimentin e Parë të Forcave Tokësore në Gjilan





Prishtinë, 24 Mars 2020. Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, me qëllim të informimit nga afër me nivelin e gatishmërisë operacionale të njësiteve të angazhuara të FSK-së, pas situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, vizitoi sot Regjimentin e Parë të Forcave Tokësore në Gjilan. Ministri Quni, gjatë vizitës u shoqërua nga stafi i tij dhe nga komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj. Ministri Quni, me këtë rast, shprehu vlerësimin e lartë dhe inkurajoi pjesëtarët e Regjimentit për përgatitjet e duhura, motivin dhe moralin e lartë të dëshmuar si gjithmonë në mbështetjen e plotë ushtarake të autoriteteve civile dhe qytetarëve tanë në përballje me sfidën aktuale që po kalojmë. Në këto rrethana të jashtëzakonshme, ku është me rëndësi jetike shëndeti i pjesëtarëve dhe i qytetarëve tanë, ministri Anton Quni, theksoi domosdoshmërinë që FSK-ja, të jetë e gatshme t'ju shërbejë të gjithë qytetarëve pa dallime etnike dhe gjithnjë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me KFOR-in. Ndërsa, ministrin Quni, me planin e gatishmërisë, nivelin e koordinimit me komandën superiore, veprimet e deritashme si dhe nivelin e gatishmërisë së kapaciteteve njerëzore specialistike, materiale, teknike dhe mbështetjes logjistike të Regjimentit përkatës e njoftoi zëvendës komandanti i Regjimentit të parë, major Kadri Berisha. Menaxhimi me sukses i kësaj situate është edhe një provë konkrete se FSK-ja dhe Kosova po tregojnë pjekurinë e duhur institucionale dhe shtetërore që të jenë pjesë e NATO-s.

Zëvendësministri Dugolli viziton Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes



Prishtinë, 16 shkurt 2020. Më 16 shkurt 2020, në organizim të KFOR-it, në Kampin „Film City" u mbajt gara „International Relay Competition"-Gara Ndërkombëtare e Stafetave. Në këtë garë morën pjesë 17 ekipe nga njësitet e KFOR-it, si dhe një ekip i Forcës së Sigurisë të Kosovës, ku secili ekip ka pasur 10 ushtarë, në mesin e tyre një femër. Garat u zhvilluan në „vrapim me bartje të stafetës në distancë të përgjithshme prej 13 kilometrave". Përkundër konkurrencës së fortë, ekipi i FSK-së zuri vendin e dytë, ku nga organizatori u shpërblye me medaljen e argjendtë. Ekipi i FSK-së përbehej nga OR-3 Alban Fazliu, OR-2 Bajram Zeneli, OR-2 Dardan Nuhaj, OR-2 Ejdon Mulaku, OR-4 Jasmin Zvarko, OR-2 Armend Neziraj, OR-2 Endrita Brahimi, OR-2 Mehdi Bala, OR-2 Zahir Mehmeti, OR-2 Visar Mehmeti, ndërsa OR-4 Ramadan Voca ishte udhëheqës i ekipit. Kjo ishte gara e parë e këtij niveli që është organizuar nga KFOR-i në Film City. Pjesëmarrja e FSK-së, në këtë ngjarje është reflektim i bashkëpunimit të shkëlqyeshëm mes FSK-së, KFOR-it dhe NALT-it.

FSK-ja në mbështetje të institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 16 Mars 2020. Bazuar në vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe me urdhër të Komandantit të FSK-së, Forca e Sigurisë së Kosovës ka ngritur gjendjen e gatishmërisë operacionale në nivelin 2 dhe ka krijuar Forcën për Detyrë. Me njësitë e specializuara për të realizuar operacione në kuadër të Mbështetjes Ushtarake Autoriteteve Civile, ka vendosur në gatishmëri personelin, pajisjet dhe sistemet për të parandaluar dhe mbrojtur qytetarët e Republikës së Kosovës nga pandemia "COVID 19". Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, udhëzon qytetarët e Republikës së Kosovës që të respektojnë të gjitha rregullat, kufizimet dhe udhëzimet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe apelon tek të gjithë që të rrisin masat e kujdesit, por në asnjë moment mos të krijojmë frikë dhe panikë. Respektimi i rregullave dhe kufizimeve është ndihma më e madhe që secili qytetar i Republikës së Kosovës i bën vendit dhe shoqërisë. Forca e Sigurisë së Kosovës ju siguron se do të jetë gjithmonë pranë qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës për t'i dalë në ndihmë në çfarëdo situate.



FSK-ja pjesë e ushtrimit fushor „KFOR 27“ në Gjermani



Gjermani, 3 Mars 2020. - Një kontingjent i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) po merr pjesë në ushtrimin fushor „KFOR 27“ në Hohenfels të Gjermanisë. Ushtrimi ka filluar me datë: 18.02.2020, në të cilin FSK-ja po merr pjesë me një skuadër të Kompanisë së Deminimit dhe oficerë stafi, së bashku me trupat ushtarake të shteteve anëtare të NATO-s: Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Shqipëria, Letonia, Italia, Rumania, Moldavia dhe Armenia. Trajnimi po zhvillohet në 5 faza: Faza e arritjes/Akomodimit, Faza e trajnimit, Faza e trajnimit të situatave, Faza e vlerësimit dhe Faza e rigjenerimit/kthimi. Gjatë fazës së parë, të akomodimit, ekipi është furnizuar me pajisje të nevojshme për trajnim, faza e dytë është fokusuar kryesisht me ligjërata që ndërlidhen me EOD-në dhe lidership, ndërsa gjatë fazë së tretë, ekipet kanë realizuar ushtrime praktike në terren. Momentalisht ushtrimi është duke u realizuar në fazën e katërt; atë të vlerësimit, ku po testohen kapacitetet intervenuese për misionin e tyre në Kosovë. FSK-ja gjatë kësaj faze po realizon intervenime të simuluara së bashku me ekipet e EOD-së të Ushtrisë Amerikane, ku qëllimi kryesor është që të njihen me praktikat e njëra-tjetrës. Paraqitja e ekipit të FSK-së, si dhe bashkëpunimi me ushtritë tjera pjesëmarrëse, e sidomos me atë të SHBA-ve, me të cilën janë duke bërë simulime të përbashkëta, u vlerësua lartë edhe nga shefi i Shtabit të Ushtrisë Amerikane (U.S Army), gjenerali James McConville, si dhe nga udhëheqësi i njësisë së EOD-së të Ushtrisë Amerikane, i cili ka theksuar profesionalizmin dhe seriozitetin gjatë intervenimit dhe është shprehur, se ekipi i tij, nuk ka asnjë hezitim që të punojë bashkërisht me njësinë e EOD-së të FSK-së, në operacione reale gjatë shërbimit në Kosovë. Qëllimi i këtij trajnimi është ngritja e profesionalizmit të njësisë së EOD-së, përgatitja e tyre për të vepruar dhe punuar në mjedis të kombinuar shumëkombësh, si dhe shkëmbimi i përvojave me shtetet partnere të NATO-s.







FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 90 • 30 Qershor 2020 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni viziton Republikën e Shqipërisë



Tiranë, 19 qershor 2020. - Me ftesë të Ministres së Mbrojtjes z. Olta Xhaçka, ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni realizon vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Në Ministrinë e Mbrojtjes, ministri Quni me delegacionin e tij u prit me ceremoni të lartë ushtarake nga ministrja Xhaçka dhe stafi i saj i lartë ministror dhe ushtarak. Në takimin dypalësh, ministrin Quni e uroi për detyrën e re homologia Xhacka, e cila shprehu bindjen se ministri Quni me përvojën si udhëheqës ushtarak i karrierës dhe me përvojën e tij të gjatë politike përfaqëson dhe do të përfaqësojë denjësisht aspiratat e Kosovës për integrimin euroatlantik dhe synimin kombëtar për zhvillimin e forcave ushtarake bashkëkohore. "Integrimi euroatlantik është synim i natyrshëm i Kosovës, krahas synimit të të gjitha vendeve të Ballkanit. Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, iu garantojmë gatishmërinë tonë për të intensifikuar bashkëpunimin mes dy vendeve e mbi të gjitha për të ndarë me Ministrinë e Mbrojtjes eksperiencën tonë lidhur me anëtarësimin në NATO", tha ministrja Xhaçka gjatë takimit mes dy delegacioneve. Ministri Quni nënvizoi se për Kosovën, krahas partneritetit me miqtë tanë të përhershëm si SHBA, pastaj Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Turqia etj., Shqipëria është aleati i natyrshëm në rrugëtimin drejt anëtarësimit në organizatat rajonale të sigurisë, programin për partneritetin për paqe dhe për t'u finalizuar me integrimin në NATO. "Objektivi kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes, pas kalimit në misionin e ri të FSK-së është përmbushja e detyrave të përcaktuara në Planin e Tranzicionit të FSK-së në forcë ushtarake, e cila do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj pa dallime etnike, kulturore, religjioni etj. Mbështetja vëllazërore e deritashme dhe ajo në të ardhmen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si në rrafshin politik ashtu edhe ushtarak është shumë e rëndësishme për operacionalitetin e FSK-së në përmbushjen e misionit dhe detyrave kushtetuese dhe ligjore, me theks në ofrimin e kontributit në operacione shumëkombëshe në ruajtje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e më gjerë" tha, në mes tjerash, Ministri Quni. Në vazhdën e diskutimeve me interes për të dy ministrat, ishte vlerësimi i krizës së pandemisë COVID-19, si sfidë të menaxhuar me sukses nga ana e dy ministrive dhe forcave në mbështetje ushtarake të autoriteteve civile dhe duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm bashkërendimin e aktiviteteve si dhe zbatimin e mësimeve të nxjerra në menaxhimit e krizës përkatëse në vijim. Pas takimit mes dy delegacioneve, ministrat Quni dhe Xhaçka dolën me një deklaratë për shtyp, ku theksi kryesor ishte thellimi i mëtejmë i bashkëpunimit dypalësh dhe rritja e mbështetjes në të gjitha fushat, respektivisht realizimi i Planit të Bashkëpunimit Bilateral mes dy ministrive. Gjithashtu, Ministri Quni theksoi se, duke ditur faktin se trajtimi i temave me interes të përbashkët nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes është shumë e gjerë ftoi ministren Xhaçka për vizitë të ndërsjellë në Kosovë. Pas takimit në Ministrinë e Mbrojtjes, delegacioni i shoqëruar nga zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi vizitoi Muzeun Historik të Forcave të Armatosura. Gjatë vizitës, delegacioni i ministrit Quni përbëhej nga komandanti i KDS-së gjeneral brigade Irfete Spahiu, ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë z. Nait Hasani, atasheu ushtarak kolonel Bashkim Shillova, drejtori i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integrime Euroatlantike kolonel Hasan Hoxha, zyrtarja e lartë Martina Dedaj Kçira si dhe këshilltarët Feriz Trezhnjeva e kolonel Hamdi Pollomi.

Nga vizita e kryeministrit Kurti në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së



Prishtinë, 2 prill 2020. Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës Albin Kurti i shoqëruar edhe nga Ministri i Financave dhe Transfereve në detyrë, Besnik Bislimi, vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së në Prishtinë. Ai u prit nga Ministri i Mbrojtjes në detyrë Anton Quni i shoqëruar nga zëvendësministri i Mbrojtjes Enver Dugolli, Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes Faruk Geci dhe Shefi i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së gjeneral brigade Jeton Dreshaj. Në fillim, ministri Quni falënderoi kryeministrin Kurti për vizitën dhe e njoftoi në pika të përgjithshme për nivelin e gatishmërisë operacionale dhe veprimet e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së në mbështetjen e autoriteteve qendrore dhe lokale civile në përballimin e situatës së krijuar pas pandemisë së COVID-19. Gjithashtu, ministri Quni, e njoftoi me objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë të Ministrisë së Mbrojtjes me fokus në rrugën përpara të realizimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së në kuadër të procesit të tranzicionit të saj. Duke shprehur mirëkuptimin e plotë në fokusin aktual të Qeverisë pas situatës emergjente nga COVID-19, ai theksoi nevojën e mbështetjes qeveritare në përmbushjen e këtyre objektivave të dimensionit të interesit shtetëror për të arritur në stadin e formësimit të plotë të forcave tona për përmbushjen e misionit të saj kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e territorit dhe pjesëmarrjes në operacionet ndërkombëtare paqeruajtëse. Ministri Quni gjithashtu e theksoi rolin e jashtëzakonshëm dhe të pazëvendësueshëm të SHBA-së dhe partnerëve tjerë në të arriturat e deritashme dhe projektet për të ardhmen duke mundësuar që FSK-ja të jetë forcë profesioniste, bashkëkohore dhe e ndërveprueshme me standardet e vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s. Në anën tjetër, Komandanti i FSK-së, e njoftoi Kryeministrin Kurti me të dhëna konkrete për objektivat operacional të FSK-së, programet dhe projektet kryesore të planifikuara për periudhën vjetore dhe afatmesme që determinojnë stadin e zhvillimit dhe operacionalizimit të plotë të aftësive dhe kapaciteteve ushtarake të planifikuara me mbështetjen e aleatit tonë kryesor SHBA-së dhe partnerëve të tjerë sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit. Me qëllim të përmbushjes së këtyre objektivave operacionalë, gjeneral Rama kërkoi nga kryeministri Kurti dhe ministri Bislimi mbështetje financiare qeveritare dhe lehtësimi nga barrierat procedurale administrative për procedimin me kohë të projekteve të veçanta të mbrojtjes. Nga ana e tij, kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për lidershipin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, për angazhimin dhe kontributin e veçantë në përballje aktuale me COVID-19, si dhe shprehu zotimin për përkrahjen e plotë në të gjitha aspektet dhe drejtimet të FSK-së, në realizimin sa më të suksesshëm të procesit të tranzicionit, si një ndër objektivat edhe të programit qeveritar të vendit. Mbështetje të plotë për të gjitha projektet e planifikuara të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, në proces dhe për të ardhmen, siguroi edhe Ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi i cili gjithashtu premtoi që do të angazhohet me prioritet të lartë, për lehtësimin dhe eliminimin e të gjitha barrierave procedurale administrative për projektet përkatëse. Vizita e kryeministrit Kurti vazhdoi në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, respektivisht në Qendrën Operative të FSK-së, ku u pritë nga ana e shefit të Stafit të SHP FSK-së gjeneral brigade Jeton Dreshaj me bashkëpunëtorë. Me këtë rast, gjeneral Dreshaj prezantoi në pika të shkurtra, punën dhe procedurat standarde të aplikuara të qendrës përkatëse, veprimet e deritashme të Forcës për Detyrë si dhe kurset e veprimit të përgatitura për të ardhmen. Pas takimeve, kryeministri Kurti dhe ministri Quni me delegacionet e tyre drekuan në kuzhinën e kazermës së FSK-së, duke respektuar masat e përcaktuara për parandalimin e COVID -19.


Ministri Anton Quni pranon letër urimi nga Ministri i Mbrojtjes së Turqisë



Prishtine, 24 Qershor 2020. Ministri i Mbrojtjes z..Anton Quni priti atasheun ushtarak të Turqisë në Kosovë, kolonel Ismail Cenkeri Ersoz. Duke e falënderuar për vizitën, edhe këtë herë, Ministri Quni shprehu mirënjohjen për mbështetjen e madhe në të gjitha aspektet që ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë qeveria dhe ushtria turke në ndërtimin e FSK-së dhe perspektivën zhvillimore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Nga ana e tij, koloneli Ersoz e falënderoi ministrin Quni për mikpritjen dhe i solli letra me mesazhe urimi për detyrën e re nga Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë, Hulusi Akar dhe ambasadori i Turqisë në Kosovë z. Çagri Sakar. Përveç mesazheve të urimeve, në letra theksohet edhe intensifikimi i bashkëpunimit dypalësh dhe fuqizimi i partneritetit, si dhe shprehet vullneti i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave Turke për vazhdimin e përkrahjes në të gjitha fushat në funksion të realizimit të objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Nga ana e tij, ministri Quni shprehu kënaqësinë për urimet me mesazhe miqësore dhe vullnetin për vizita të ndërsjella me homologun Akar si dhe thellimin e bashkëpunimit dypalësh, duke vlerësuar lart rolin e Turqisë si vend anëtar i NATO-s në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Në këtë takim koloneli Ersoz shoqërohej nga këshilltari ushtarak i ministrit të Mbrojtjes dhe komandantit të FSK-së nga FA të Turqisë, kolonel Mehmet Kurtpinar.

Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i FSK-së nderojnë ushtarët e NATO-s, presidentin Ibrahim Rugova dhe heroin e Kosovës Zahir Pajaziti

Prishtinë, 12 qershor 2020. Me rastin e 21- vjetorit të çlirimit të Kosovës, më 12 Qershor, në datën historike të çlirimit të Kosovës, ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni bashkë me gjenerallejtënant Rrahman Rama, u.d. i sekretarit të përgjithshëm z. Faruk Geci, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj dhe oficerë të lartë të FSK-së, bënë homazhe dhe vendosën lule te: pllaka përkujtimore e ushtarëve të rënë të NATO-s dhe KFOR-it gjatë misionit në Kosovë; shtatorja e Presidentit historik Ibrahim Rugova, në shenjë nderimi dhe respekti për veprën jetësore dhe kontributin e tij në orientimin e politikës kosovare në drejtim të Aleancës Euroatlantike; dhe te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti- luftëtarit të orëve të para të UCK-së, në nderim dhe respekt deri në përkulje të kontributit, sakrificës dhe rënies së tij heroike.



Fjala e Ministrit Quni për 100 ditshin e parë të Qeverisë së Kosovës



Prishtinë, 14 maj 2020. Në cilësinë e Ministrit të Mbrojtjes, bazuar në përgjegjësitë e mia zyrtare dhe profesionale, ju njoftoj me punën e 100 ditëve të para në Ministrinë e Mbrojtjes, përkatësisht realizimin e aktiviteteve kryesore të saj. Me kënaqësi ju njoftoj se, përkundër situatës së paparashikuar të shkaktuar nga pandemia COVID-19, Ministria e Mbrojtjes ka arritur me sukses të realizojë pjesën më të madhe të aktiviteteve të planifikuara për periudhën e 100 ditëve të para të Planit Vjetor të Qeverisë dhe Ministrisë, në funksion të përmbushjes së objektivave programor të Qeverise dhe të miat si ministër i Mbrojtjes. Meqë jemi në vitin e dytë të procesit të tranzicionit të FSK-së në misionin e forcës ushtarake, edhe objektivat tanë janë me fokus në përmbushjen e aktiviteteve në përputhje me Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, gjithnjë në drejtim të arritjes së aftësive dhe kapaciteteve operacionale të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor. Me synimin vjetor të përfundimit të pakos së dokumenteve strategjike dhe atyre planifikuese, kemi arritur të hartojmë draftin e dokumentit më të lartë strategjik të mbrojtjes-Strategjinë e Mbrojtjes dhe draftet e dy dokumenteve të tjera strategjike si Strategjinë e Burimeve Njerëzore dhe bashkëpjesëmarrjen në hartimin e Strategjisë Shtetërore Pesëvjeçare për Siguri Kibernetike. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është përgatitur Plani Trevjeçar i Punës së Qeverisë bazuar në prioritetet e Qeverisë nga fushëveprimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Bazuar në planin legjislativ, në spektrin e hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore të planifikuara kemi hartuar: Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deminim humanitar; si dhe tri koncept-dokumentet si: për dërgim të FSK jashtë vendit; për Komponentin Rezervë dhe për Policinë e Ushtarake. Koncept-dokumenti për shërbimin e obligueshëm ushtarak është në proces të diskutimit me partnerët tanë, krahas procesit të analizave dhe vlerësimeve të nevojshme para-inicuese për hartim. Gjatë kësaj periudhe, Ministria e Mbrojtjes, për herë të parë në nivel të vendit ka udhëhequr trajtimin e Pyetësorit të Transparency International për indeksin e korrupsionit në strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë duke u trajtuar nga kjo organizatë me renome, krahas ministrive tjera të Mbrojtjes nga e gjithë bota. Kemi vazhduar me aktivitetet e planifikuara që ndërlidhen me avancimin dhe zhvillimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale, infrastrukturore, financiare. Kemi vazhduar me avancimin e standardeve të transparencës, llogaridhënies, integritetit, kredibilitetit dhe imazhit institucional. Në funksion të kësaj janë zhvilluar aktivitetet e koordinuara për kontrollin e brendshëm dhe transparencën e llogaridhënien e institucionit përmes Zyrës Kombëtare të Auditimit, Njësisë së Auditorit të Brendshëm dhe Inspektoratit të Përgjithshëm të FSK-së. Për këtë kam formuar edhe Komitetin e Auditimit të Brendshëm për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Kemi vazhduar me aktivitetet në funksion të thellimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në çështjet e mbrojtjes si dhe vazhdimin e bashkëpunimit me Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) dhe KFOR-in. Pas ndryshimit të misionit të MM dhe FSK-së është parë e nevojshme rishikimi i Marrëveshjeve Bilaterale (MOU) me shtetet partnere. Në këtë fazë janë nënshkruar planet bilaterale me: SHBA-të, Turqinë, Gjermaninë, Holandën, Shqipërinë dhe Francën dhe janë në proces planet bilaterale me Kroacinë dhe Maqedoninë e Veriut. Në funksion të sigurisë së vendit, Ministria e Mbrojtjes ka qenë në koordinim të përhershëm dhe intensiv me strukturat tjera vendore të sigurisë si AKI-në dhe Policinë e Kosovës si dhe strukturat rajonale e lokale të sigurisë. Gjatë procesit të menaxhimit të krizës së pandemisë COVID-19, janë realizuar me sukses të plotë të gjitha detyrat e misionit të FSK-së në mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile, në kuadër të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me të gjitha institucionet vendore dhe partnere ndërkombëtare. Pjesëmarrja, kontributi dhe angazhimi ynë është ofruar që nga niveli udhëheqës qeveritar dhe ndërinstitucional deri në nivelet operacionale e taktike gjatë të gjitha fazave të planifikimit, gatishmërisë dhe reagimit në interval kohor të pandërprerë 24/7.

Komandanti i FSK-së deklaron gatishmërinë e FSK-së për menaxhimin e COVID-19



Prishtinë, 16 prill 2020. Në këto ditë të vështira për vendin tonë, FSK-ja vazhdon të zhvillojë operacione të mbështetjes ushtarake për autoritetet civile me qëllim menaxhimin e situatës së krijuar për shkak të pandemisë me Covid -19. Pjesëtarët e FSK-së janë duke kryer detyrat me vetëmohim dhe profesionalizëm të lartë. Gjatë kësaj periudhe njësitë e Komandës së Logjistikës dhe Policisë Ushtarake të FSK-së, kanë zhvilluar aktivitete transportuese nga të gjitha pikat kufitare dhe Aeroporti Ndërkombëtarë „Adem Jashari" për në vend-karantinë. Njësitë e FSK-së gjithashtu kanë mbështetur me tenda, kontejner dhe pajisje përcjellëse qendrat spitalore të Kosovës. FSK-ja ka vendosur në gatishmëri Ekipe Mjekësore statike dhe mobile, njëkohësisht ka vendosur dhe mobilizuar Qendrën Mjekësore të FSK-së, dhe paralelisht, po vazhdon të mbështes Qendrën Operative të MPBAP-së (Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike) dhe shtabet emergjente komunale me oficerë shtabor. FSK-ja si gjithmonë është e përkushtuar dhe e vendosur për të ndihmuar qytetarët dhe institucionet e Kosovës, andaj duke vlerësuar shërbimin vetëmohues dhe mbështetjen që duhet t'i japim vendit dhe qytetarëve në këtë kohë të krizës me pandemi globale, kam kërkuar nga Ministri i Mbrojtjes dhe Qeveria në Detyrë që mjetet financiare shtesë të ndara për pjesëtarët e FSK-së t`i dedikojnë dhe adresojnë për nevoja të tjera. Andaj ne vazhdojmë me gatishmëri t`u shërbejmë qytetarëve, t'i mbështesim institucionet dhe popullin në të gjitha sfidat.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ministri Anton Quni priti ambasadorin e Republikës së Italisë Nicola Orlando



Prishtinë, 23 qershor 2020. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni priti në takim zyrtar ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë Nicola Orlando. Me këtë rast, ministri Quni falënderoi ambasadorin Orlando për vizitën e tij, dhe shprehu mirënjohjen për Republikën e Italisë, si vend mik, në mbështetjen e ofruar vendit tonë deri më tani në të gjitha fushat, duke theksuar rolin e saj në ndërtimin dhe arritjet e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ai shprehu mirënjohjen e lartë për kontributin e madh në sigurinë e përgjithshme të kontingjentit ushtarak italian në kuadër të KFOR-it, të udhëhequr me sukses nga gjeneralët e shumtë italianë, duke theksuar edhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me komandantin aktual të KFOR-it, gjeneral major Michele Risi. Ministri Quni nënvizoi rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimit dypalësh i MM- së dhe FSK-së me Ministrinë e Mbrojtjes të Italisë dhe Forcat e Armatosura të saj, duke pasur parasysh përvojën e madhe italiane në procesin e integrimeve euroatlantike dhe të forcave ushtarake italiane në ngritjen dhe zhvillimin e operacionalitetit ushtarak në përgjithësi. E gjitha kjo me fokus në ngritjen e forcave për pjesëmarrje cilësore në operacione paqeruajtëse. „Pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse është ndër detyrat kryesore ligjore të FSK-së, andaj edhe synimi ynë është zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve operacionale në pajtueshmëri dhe ndërveprueshmeri me forcat e vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s. Ky synim do të kurorëzohet me ofrimin e mundësisë për ofrimin e kontributit tonë në kuadër të forcave shumëkombëshe për paqen, stabilitetin dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë“ tha ai. Nga ana e tij, ambasadori Orlando, uroi ministrin Quni, për detyrën e ministrit të Mbrojtjes duke konfirmuar angazhimin e Italisë në stabilitetin e rajonit përmes KFOR-it. Ambasadori shprehu interesin e tij për vizionin e ministrit mbi të ardhmen e sigurisë së Kosovës, duke përfshirë edhe nismat e qeverisë së re. Në përmbyllje të takimit, ambasadori Orlando, siguroi se Republika e Italisë do të vazhdojë të mbështesë në mënyrë aktive perspektivën euro-atlantike të Kosovës duke theksuar se do të mbajë kontakte të ngushta me ministrin Quni lidhur me këtë. Në delegacionin pritës të ministrit Quni, ambasadori Orlando, shoqërohej nga këshilltari në Ministrinë e Mbrojtjes, kolonel Vincenzo Stella.


Ministri Quni zhvillon bisedë telefonike me homologen e tij Radmila Shekerinska



Prishtinë, 13 prill 2020. Ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut zonja .Radmila Shekerinska, ka zhvilluar një bisedë telefonike me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës z.Anton Quni. Në bisedën e tyre të dy ministrat kanë shkëmbyer mendime rreth situatës së e krijuar në të dy shtetet pas përhapjes së pandemisë COVID-19, situatën e përgjithshme dhe menaxhimin e saj, gjendjen e gatishmërisë dhe aktivitete e ushtrive përkatëse si dhe masat e marra për përballimin e kësaj situate të jashtëzakonshme, të krijuar jo vetëm në nivel rajonal por edhe ndërkombëtar. Me këtë rast, ministrja Shekerinska ka shprehur gatishmërinë e Maqedonisë së Veriut, ushtrisë së saj, përkatësisht ka vënë në dispozicion shërbimet e Njësisë Atomike, Kimike dhe Biologjike, për të ndihmuar në rast nevoje përballimin e gjendjes emergjente në Kosovë. Ministri Quni e ka falënderuar përzemërsisht ministren Shekerinska për gatishmërinë e treguar në këto ditë të vështira. Ai e ka njoftuar homologen e vet me situatë aktuale në Kosovë, me masat që janë marrë nga Qeveria e vendit në përballimin dhe menaxhimin e kësaj situate të jashtëzakonshme. Ai e ka njoftuar edhe me shkallën e gatishmërisë dhe aktivitet konkrete që po ndërmerr FSK-ja për përballimin e kësaj situate, si brenda strukturës së vet ashtu edhe në nivel shtetëror. Ministri Quni i ka shprehur ministres Shekerinska gatishmërinë e FSK-së, në rast nevoje, për ta mbështetur Republikën e Maqedonisë së Veriut me kapacitetet e specializuara që ka në gatishmëri FSK-ja.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes pjesë e takimit të iniciativave rajonale SHBA-Karta e Adriatikut A5

Prishtinë, 20 maj 2020. Sot u mbajt takimi i drejtorëve të politikave të ministrive të Punëve të Jashtme dhe Ministrive të Mbrojtjes në kuadër të iniciativës rajonale SHBA-Karta e Adriatikut A5, e cila këtë vit kryesohet nga Bosnja dhe Hercegovina. Takimin e udhëhoqi Almir Shahovic, asistent ministër i Punëve të Jashtme të Bosnjës e Hercegovinës, përmes video-konferencës, ku pjesëmarrës ishin të gjithë anëtarët e kësaj iniciative, përfshirë edhe anëtarët vëzhgues. Delegacioni i Republikës së Kosovës u përfaqësua nga u.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes Faruk Geci, Lulzim Hiseni, drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe kolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrime Euro-Atlantike (MM). Tema e takimit në fokus ishte bashkëpunimi rajonal, me theks të veçantë, situata aktuale pas pandemisë COVID-19. Gjatë konferencës u raportua për angazhimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti, sekretari Geci, njoftoi për rolin e Forcës së Sigurisë të Kosovës në mbështetje të autoriteteve civile. Gjithashtu gjatë punimeve të Konferencës SHBA-Karta e Adriatikut A5, edhe një herë u ritheksua vullneti i Republikës së Kosovës për anëtarësim me statusin e anëtarit të plotë në iniciativën rajonale SHBA - Karta e Adriatikut A5.



FORCA JONË

Diplomojnë kadetët e gjeneratës 2020 të Q



Prishtinë, 29 qershor 2020. Në hapësirat e kazermës „Adem Jashari“, u mbajt ceremonia ushtarake e diplomimit të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës 2016-2020. Në ceremoninë e organizuar, me një pjesëmarrje të kufizuara për shkak të masave kundër COVID-19, morën pjesë: Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ish-kryeministri i vendit Ramush Haradinaj, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) gjeneral brigade Frank Best, u.d. i sekretarit të përgjithshëm të MM-së Faruk Geci, stafi i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, atashe ushtarakë të vendeve partnere, oficerë të NALT-it, këshilltarë ushtarakë dypalësh, si dhe familjarë të kadetëve të diplomuar. Pas nderimit të flamurit, me një fjalë përshëndetëse të pranishmëve ju drejtua nikoqirja e ceremonisë, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (komandë brenda së cilës vepron edhe QSU-ja), gjeneral brigade Irfete Spahiu. Gjeneral Spahiu pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, ua rikujtoi kadetëve rrugëtimin e përbashkët me të gjitha strukturat e komandës që udhëheq për të realizuar arritjen e standardeve më të larta profesionale dhe akademike me programin tejet sfidues për përgatitje psikike, fizike, profesionale dhe intelektuale. Ajo, në mesazhin e urimit shprehu besimin për sukseset e kadetëve edhe në vazhdim të karrierës së tyre si oficerë ushtarakë, gjithnjë me moton “ E ardhmja fillon këtu“. “Po bëhen më shumë se dy dekada nga koha kur populli i këtij vendi u çlirua dhe më shumë se dy dekada kur unë vendosa të bëhem pjesë e ushtrisë, por ajo çka nuk ndryshon asnjëherë te një ushtarak është kontributi për atdhe dhe jo vetëm në kohë lufte por edhe paqeje”, tha ndër të tjera ajo. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, në mesazhin e tij drejtuar kadetëve të diplomuar, i inkurajoi të qëndrojnë konsekuent në realizimin e synimeve me frymën dhe shpirtin luftarak, gjithmonë duke ruajtur prestigjin e FSK-së dhe vlerat themelore të ushtarakut, si Detyrën, Nderin dhe Atdheun. “Detyra, Nderi dhe Atdheu janë vlerat që do t’ju vendosin nga kjo ditë në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim, vlera këto që janë tashmë të ngulitura në zemrat tuaja”, tha ndër të tjera gjeneral Rama. Ai gjithashtu, shprehu falënderimin për partnerët tanë të cilët me mbështetjen e madhe mundësua zhvillimin dhe avancimin e QSU-së me programe të akredituara në gjuhën angleze sipas standardeve më të avancuara të vendeve partnere, anëtare të NATO-s, për çka edhe kanë ofertën e hapur për të sjellë kandidatë të tyre për studime në Qendrën tonë. Ministri i Mbrojtjes z.Anton Quni, në adresimin e tij para të pranishmëve, iu drejtua kadetëve të diplomuar me emra të përveçëm. “Jo pa qëllim po i theksoj emrat tuaj. Dua këta emra t’i dëgjoj çdo qytetar dhe të kuptohet se pse ju jeni të veçantë dhe pse ky moment është i veçantë”, theksoi ministri Quni. Si ish-ushtarak karriere, ministri Quni ua rikujtoi kadetëve rrugëtimin me përplot sprova e sfida gjatë studimeve si, testet e stërvitjet për qëndrueshmëri morale e kalitje fizike, përballja me kushtet e mbijetesës, marshimet e gjata e të mundimshme e deri te leksionet e provimet e shumta profesionale e akademike gjithnjë me të jetuar nën regjimin e rreptë të disiplinës ushtarake. Duke shprehur besimin e plotë në suksesin dhe fitoren e garantuar të tyre në përmbushjen e misionit gjatë shërbimit si lider ushtarak, ai tha se ”kjo do të arrihet nga ju gjithmonë sepse udhëhiqeni nga vlerat e shenjta të ushtarakut, Detyrës , Nderit dhe Atdheut”. “Unë besoj se ju edhe më shumë do t’i forconi urat e miqësisë me SHBA-në dhe partnerët tjerë strategjikë. Falënderimi dhe mirënjohja është dhe do të jetë e përjetshme për NATO-n dhe miqtë tanë që në kohërat më të vështira na qëndruan pranë. Pran-







endrës për Studime Universitare të FSK-së





daj përgatituni që të zbarkoni edhe jashtë vendit, që me gatishmërinë tonë profesionale dhe morale t'i shërbejmë njerëzimit dhe paqes kudo ku ka nevojë. Çdo kund dhe në çdo kohë barteni me vete dashurinë e Nënës Terezë, urtësinë e Presidentit Rugova dhe guximin, trimërinë dhe sakrificën e Adem Jasharit dhe familjes Jashari", tha ministri Quni. Në fund, ai theksoi se, "synimi ynë strategjik është anëtarësimi në NATO" dhe shprehu bindjen e plotë se "me kuadro të këtilla, pavarësisht sfidave gjeopolitike të çastit, e ardhmja euroatlantike e vendit është e sigurt". Ceremonia vazhdoi me ndarjen e diplomave për 15 kadetët e diplomuar nga ministri Quni, gjeneral Rama dhe gjeneral Spahiu. Në mesin e të diplomuarve ishte kadetja nga Republika e Shqipërisë Lirza Dollomaja e cila bazuar në rezultatet dhe performancën e dëshmuar, u dekorua edhe si "Kadetja më e dalluar e gjeneratës 2020", ndërsa me motivacionin e njëjtë, u dekorua edhe "Instruktori më i dalluar i QSU-së", toger Shpend Halimi. Në emër të kadetëve të diplomuar me një fjalë rasti të pranishmit i përshëndeti, kadetja Dollomaja, e cila tha se me vendosmëri të madhe arritëm suksesin dhe se si oficerë do të jemi në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit kudo në botë.





Dy kadetët e parë të FSK-së diplomojnë në Akademinë Ushtarake „West Point" të SHBA-ve

SHBA, 15 qershor 2020. Pas studimeve 4-vjeçare në Akademinë Ushtarake më prestigjioze në SHBA dhe në Botë, e njohur edhe si West Point, me traditë 218 vjeçare, dy kadetët e FSK- së, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku, diplomuan me sukses të lartë. Suksesi i kadetëve të FSK-së është i veçantë pasi që për herë të parë në Akademinë Ushtarake prestigjioze West Point në SHBA u diplomuan dy kadetë nga Kosova. E veçanta e kësaj ngjarje është edhe fakti se në ceremoninë e diplomimit, këtë vit, mbajti fjalim edhe Presidenti i SHBA-ve Donald Trump. Ceremonia e diplomimit u mbajt nën masa të rrepta për parandalimin e pandemisë COVID-19, e cila pamundësoi edhe pjesëmarrjen e mysafirëve, familjarëve të kadetëve dhe të publikut të gjerë. Në mesin e 1100 kadetëve të diplomuar në këtë gjeneratë, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku janë dy oficerët e rinj të FSK-së, të cilët njohuritë profesionale dhe akademike për doktrinat e taktikave ushtarake më të avancuara në Botë, do t'i zbatojnë me ushtarët dhe nënoficerët e FSK-së. Edhe përshtypjet për rëndësinë e ngjarjes dhe suksesit ishin të veçanta nga të dy kadetët. „Mbi të gjitha kjo ditë më ka ngjall ndjenja krenarie pasi e kam pasur nderin ta përfaqësoj vendin në një skenë ndërkombëtare si West Pointi. Motoja me të cilën kthehem në Kosovë është – Detyra, Nderi, Atdheu – e cila rrit ndjenjën e përgjegjësisë për t'i kontribuar vendit tim" theksoi kadetja Arelena Shala, si gruaja e parë shqiptare që diplomohet në një akademi ushtarake në fushën e inteligjencës gjeohapësinore. Kurse Ylli Dalladaku thotë se njohuritë e fituara për inxhinieri dhe aeronautikë në West Point i ka të ndërtuara mbi vlerat e Detyrës, Nderit dhe Atdheut, si faktorët kryesorë të suksesit, për çdo ushtri. „Unë do të punoj jashtëzakonisht shumë që ta inspiroj togun tim. Do të udhëheq me shembullin personal, duke iu ofruar kompetencë, dedikim ndaj detyrës dhe disiplinë", theksoi në fund kadet Dalladaku. Kadetët tanë kanë përfaqësuar denjësisht vendin tonë dhe FSK-në, duke u radhitur në 5 përqindëshin e studentëve me rezultatet më të mira në klasën e tyre. Suksesi i tyre është njëherësh edhe mirënjohja dhe vlerësimi



më i mirë për mbështetjen jetike të SHBA-së dhe forcave të saj, si aleatët tanë të pazëvendësueshëm. Në këtë aspekt, kjo mbështetje vazhdon edhe me pranimin e tre kadetëve të rinj, që këtë vit, fillojnë shkollimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga të cilët; dy në West Point, dhe një kadet për herë të parë në Forcat Ajrore të SHBA-së.

Ministri Quni dhe gjeneral Rama në ceremoninë lamtumirese të shefit të Shtabit të KFOR-it, gjeneralit Shawn Harris



Prishtinë, 23 qershor 2020 - Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni i shoqëruar nga komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shefi i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, morën pjesë në ceremoninë lamtumireshe të shefit të Shtabit të KFOR-it gjeneral brigade Shawn Harris, e mbajtur në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it në Film City. Në pritjen lamtumireshe, gjenerali Harris i shoqëruar edhe nga pasardhësi i tij gjeneral Larry Henry, falënderoi ministrin Quni dhe gjeneral Ramën për bashkëpunimin e ngushtë dhe iu uroi suksese në realizimin e objektivave të synuar në zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Ministri Quni e falënderoi gjeneralin amerikan dhe shprehu mirënjohjen e thellë për bashkëpunimin e ngushtë dhe të suksesshëm gjatë mandatit të tij në detyrën tejet të rëndësishme siç është përgjegjësia e Shefit të Shtabit të KFOR-it. Ministri Quni dhe gjeneral Rama i uruan gjeneralit Harris suksese në detyrat dhe përgjegjësitë e reja në kuadër të forcave mike amerikane, si dhe përgëzuan pasardhësin e tij gjeneralin Henry duke shprehur gatishmërinë e plotë për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në të ardhmen mes FSK-së dhe KFOR-it.

Ministri Anton Quni viziton njësitë e KFT-së në Aeroportin e Gjakovës

Gjakovë, 26 qershor 2020. Me qëllim të njoftimit nga afër me operacionet e njësive të FSK-së, ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni së bashku me stafin e tij vizitoi njësitë e Komandës së Forcave Tokësore (KFT), që po realizojnë kursin 'Komando - Bereta' në Aeroportin e Gjakovës. Ministrin Quni, gjatë vizitës u prit nga komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj dhe oficerë të lartë të Komandës. Së pari, gjenerali Hadërgjonaj e njoftoi ministrin Quni me objektivat e ushtrimit, kapacitetet njerëzore dhe teknike si dhe me nivelin e arritjeve profesionale të ushtarëve të FSK-së gjatë këtij ushtrimi. Ndërkaq, ministri Quni e përgëzoi Komandën e Forcave Tokësore për realizimin mjaft profesional të këtij ushtrimi. Ndër të tjera ai vlerësoi lart faktin se "edhe pse gjendemi në kohë të pandemisë COVID-19, ushtarët e FSK-së janë në formacion të plotë, duke kryer ushtrimet e planifikuara me disiplinë dhe përkushtim të madh, duke treguar nivel të lartë profesionalizmi dhe aftësi taktike operuese". Ministri Quni, para oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të njësisë përkatëse, u zotua për ofrimin e mbështetjes maksimale për të avancuar edhe më tej përmbushjen e detyrës së shenjtë në kuadër të misionit të mbrojtjes së vendit dhe sigurisë së qytetarëve të saj.

FSK-ja hapi ekspozenë e konferencës ndërkombëtare për mjekësi

Prishtinë, 11 qershor 2020. Me ftesë të organizatorit të Seminarit dhe Panairit Mjekësor Ushtarak (WEBEX) të Turqisë, koloneli i FSK-së, dr. Xhevdet Tahiraj, drejtor i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, mori pjesë, përmes video-lidhjes, drejtpërdrejt në punimet e konferencës ndërkombëtare për mjekësi të mbajtur në Turqi. Ceremoninë e hapjes së konferencës e bëri, koloneli, dr. Xhevdet Tahiri, i cili, ndër të tjera, tha: „Dëshiroj të shpreh respektin më të thellë për Republikën e Turqisë dhe në veçanti për organizatorët e kësaj konference, për ftesën dhe për nderin që më ofruan për hapjen e punimeve të kësaj konference. Ne e vlerësojmë shumë pjesëmarrjen në Seminarin dhe Panairin Mjekësor Ushtarak, dhe mendojmë se gjatë këtyre bashkëbisedimeve do të fitojmë njohuri të reja dhe do të ndajmë përvojat në luftimin e COVID-it-19, këtij armiku të përbashkët dhe të padukshëm. Dëgjimi i përvojave të vendeve tjera, se si ato arritën ta menaxhojnë këtë pandemi, është mjaft i rëndësishëm për të krijuar një koncept për përballimin sa më mirë të ndonjë vale të re të mundshme. COVID-19, në fakt, na ka mësuar se si së bashku mund të luftohet dhe të menaxhohet më lehtë përhapja e ndonjë virusi. Mund ta quajmë mësim të kohës moderne, i cili na mësoi të jemi të gatshëm për kërcënime pandemie të panjohura si COVID-19, se si të merren masa duke ngritur nivelin e reagimit dhe të bëhen plane konkrete për parandalimin e ndonjë sëmundjeje apo infeksioni. Që nga fillimi i pandemisë në botë, përpara se ajo të shfaqej në vendet e rajonit, ne si vend filluam përgatitjet e para. Konkretisht, në Ministrin e Shëndetësisë krijuam Komitin Kombëtar për Monitorimin e Sëmundjeve Infektive, në veçanti COVID-it-19, duke përgatitur edhe Planin e gatishmërisë për reagim. Në menaxhimin e COVID-19, FSK-ja me Task-Forcën e saj, me urdhër të komandantit, gjenerallejtënant Rrahman Rama, dhe në bashkëpunim e bashkërendim me partnerët ndërkombëtarë, u dallua duke iu ofruar mbështetje ushtarake autoriteteve civile, institucioneve qendrore dhe lokale, Institutit Kosovar të Shëndetit Publik dhe agjencive të tjera civile. Nga 14 marsi, kur edhe është evidentuar rasti i parë, deri më 31 maj 2020, Forca e Sigurisë e Kosovës zhvilloi 659 aktivitete". Në fund të fjalës së tij, koloneli Dr. Xhevdet Tahiri, shtoi se: „Përmes këtij WEBEX-si shpresojmë ta forcojmë bashkëpunimin tonë në fushën e mjekësisë ushtarake. Paraqitja e kolonel Tahirit u vlerësua lart nga organizatori i kësaj konference.

Mbledhje komemorative për punëtorin e MM, Sylë Zhitia



Prishtinë, 18 maj 2020. Në organizim të Kabinetit të Ministrit, në Ministrinë e Mbrojtjes u mbajt mbledhja komemorative për zyrtarin e Ministrisë së Mbrojtjes, Sylë Zhitia. Në këtë mbledhje morën pjesë ministri i Mbrojtjes Anton Quni, zëvendësministri i mbrojtjes Enver Dugolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, u.d. i sekretarit të përgjithshëm Faruk Geci, zyrtarë dhe oficerë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së si dhe zyrtarë të NALT-it. Në mbledhje morën pjesë edhe familjarët e të ndjerit, respektivisht i biri Dritëroi me bashkëshorten e tij. Në fjalën e tij, ministri Quni, shprehu tronditjen dhe dhimbjen e madhe që shkaktoi ndarja nga jeta e Sylës, si humbje e madhe jo vetëm për familjen por edhe për ne si institucion dhe shoqërinë në përgjithësi. Në vazhdim, ministri Quni përkujtoi burimin e frymëzimit, brumosjes e kalitjes si veprimtar, patriot, luftëtar e njeri i përkushtuar me të gjithë qenien e tij, gjatë gjithë jetës, në përpjekje për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Ishin pra, paraardhësit dhe bashkëkohësit e tij duke përmendur gjyshërit dhe të vëllain, heroin e kombit Afrim Zhitinë. Në fund, ministri Quni theksoi se të gjitha këto vlera të Sylës reflektuan edhe në karakterin dhe personalitetin e tij moral dhe profesional dhe mundësuan që ne Ministria e Mbrojtjes të kemi në radhët tona një mik e bashkëpunëtor me dinjitet e integritet të lartë. "Vdekja e ndau vetëm fizikisht, sepse Syla do të jetë gjithmonë me ne, miqtë, bashkëpunëtorët dhe kolegët e tij. Ne bashkë me Sylën do të rrugëtojmë përpara deri në realizimin e plotë të ide-



alit të tij, Afrimit, paraardhësve të tij dhe të gjithë veprimtarëve, dëshmorëve dhe martirëve të Kombit për ushtri të fortë, shtet të zhvilluar e komb prosperues", tha në fund ministri Quni. Në emër të familjes, të pranishmit i përshëndeti i biri i të ndjerit, Dritëroi duke e falënderuar ministrin Quni për telegramin e ngushëllimit dhe organizimin e kësaj mbledhjeje. Gjithashtu, ai shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për të gjithë miqtë dhe bashkëpunëtorët e të atit nga Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja për vlerësimin e lartë për të, dhe që po u qëndrojnë pranë në këto qaste të rënda.

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni vizitoi deminerët në Babaj të Bokës



Prishtinë, 14 maj 2020. Me qëllim të njoftimit nga afër me operacionet e deminimit të FSK-së, ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni me stafin e tij, sot vizitoi njësinë operuese të deminimit të FSK-së që është duke zhvilluar operacionin e deminimit në Babaj të Bokës të komunës së Gjakovës. Ministrin Quni e priti komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së gjeneral brigade Xhevahir Geci i shoqëruar nga Komandanti i Kompanisë së Deminimit major Gëzim Sada. Si nikoqir, Major Sada e njoftoi ministrin Quni me aftësitë dhe kapacitetet njerëzore, me pajisjet dhe kapacitetet tjera teknike, me kapacitetet trajnuese dhe nivelin e profesionalizimit si dhe me kapacitetet e mbështetjes logjistike dhe infrastrukturore të njësisë. Më pas ministri Quni u njoftua në hollësi me operacionet e deritashme dhe ato të planifikuara të deminimit dhe veçanërisht me operacionin aktual në Babaj të Bokës. Nga ana e tij, ministri Quni, përgëzoi Gardën Kombëtare, respektivisht Kompaninë e Deminimit për të arriturat e jashtëzakonshme përgjatë gjithë procesit të deminimit , duke demonstruar nivel shumë të lartë të përgjegjësisë dhe profesionalizimit. Në fund, ministri Quni para oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të njësisë përkatëse u zotua për ofrimin e mbështetjes maksimale për të avancuar edhe më tej në përmbushjen e detyrës së shenjtë, në kuadër të misionit të mbrojtjes dhe sigurisë së qytetarëve tanë.

Zëvendësministri Dugolli vizitoi komunat Skenderaj dhe Drenas



Prishtinë, 1 prill 2020. Zv. ministri i Mbrojtjes Enver Dugolli, vizitoi komunën e Skenderajt dhe atë të Drenasit, me qëllim të njoftimit nga afër me nivelin e gatishmërisë operacionale për përballimin e pandemisë COVID-19. Zv. ministri Dugolli u prit në takime të ndara nga kryetari i Skenderajt Bekim Jashari dhe ai i Drenasit Ramiz Lladrovci, me të cilët bisedoi rreth bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërinstitucional për menaxhimin e gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19. Me këtë rast, zv. ministri Dugolli, tha se; „Gjatë takimit me kryetarët Bekim Jashari dhe Ramiz Lladrovci shpreha gatishmërinë e institucioneve qendrore për t'u dalë në ndihmë komunave dhe qytetarëve të saj. I gjithë fokusi i Qeverisë në detyrë dhe i institucioneve tjera është drejtuar në luftën sa më efikase kundër armikut të përbashkët global, Corona Virusit COVID-19. Për ta mundur këtë virus, nevojitet një bashkëpunim dhe bashkërendim i të gjithëve, pa dallim, në mënyrë që sa më lehtë dhe sa më me pak pasoja ta kalojmë këtë situatë". Në fund, zv. ministri Dugolli, tha: „Forca e Sigurisë e Kosovës është e gatshme t'i mbështes autoritetet civile. Kryetarët e të gjitha komunave mund të llogarisin në mbështetjen tonë me kapacitete logjistike në këtë fazë të ndjeshme nëpër të cilën po kalojmë".

Koloneli Sylejman Cakaj diplomohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

SHBA, 12 qershor 2020. Oficeri i lartë i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) koloneli Sylejman Cakaj, ka kryer me sukses të shkëlqyeshëm studimet në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes të SHBA-së, në Uashington D.C, ku mori diplomën e Masterit për Studime Strategjike të Sigurisë, si dhe diplomën e Shkollimit Profesional Ushtarak (JPME II) të SHBA-së. Gjithashtu nga kolegji „CISA", ka marrë çmimin „Student i dalluar." Kolonel Cakaj, para se të shkonte për studime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka kryer detyrën e komandantit i Regjimentit të III-të të Komandës së Forcës Tokësore (KFT) në Mitrovicë. Gjatë studimeve, kolonel Cakaj, është dalluar me paraqitjen e shkëlqyeshme në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes në Uashington D.C. Ai, gjithashtu me sukses të lartë ka mbrojtur temën e Masterit në fushën e studimeve strategjike të sigurisë, dhe njëherësh për paraqitjen e mirë shpallet „Student i dalluar" nga kolegji CISA. Për gjithë të arriturat, kolonel Cakaj, ka falënderuar FSK-në, për përkrahjen e pa rezervë, familjen dhe shokët e tij. Ai, premtoi se përvojën ushtarake të fituar në SHBA, do ta përcjellë tek ushtarët e tij në Forcën e Sigurisë së Kosovës.



Halime Morina - Lupçi nderohet me mirënjohje në Ditën Ndërkombëtare të Shërbimit Civil në Kosovë



Prishtinë, 24 qershor 2020. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Shërbimit Civil në Kosovë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, ka shënuar këtë ditë me një ceremoni rasti. Për kontributin e dhënë në fushën e administratës publike, Ministria e Mbrojtjes për vitin 2019/2020, ka përzgjedhur si nëpunëse më të dalluar të vitit, znj. Halime Morina–Lupçi, shefe e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore. Në fund të kësaj ceremonie u bë edhe ndarja e mirënjohjeve për kontributin dhe angazhimin e nëpunësve më të dalluar të shërbimit civil në Republikën e Kosovës.

Edhe një kadete e re e FSK-së në Akademinë Ushtarake “West Point” në SHBA



Prishtinë, 23 prill 2020. Sukseset e Forcës së Sigurisë vazhdojnë. Më 22.04.2020, është pranuar konfirmimi zyrtar nga Akademia Ushtarake “West Point” e Shteteve të Bashkuara të Amerikës se kadetja Vesa Ibrahimi është përzgjedhur nga Kosova të ndjek studimet në gjeneratën 2024.Vesa ka kaluar të gjitha testimet me arritje të lartë, si pjesën akademike ashtu dhe atë fizike. Ajo ka fituar të drejtën për të ndjekur studimet katërvjeçare dhe për t'u kthyer në shërbim në FSK pas përfundimit të Akademisë. “Jemi mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme të SHBA-së dhe Ambasadës në Kosovë, për mundësin e ngritjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës në të gjitha fushat, ngritjen e kapaciteteve njerëzore në Akademitë më prestigjioze në Botë, në krijimin e liderëve të ardhshëm të FSK-së”.

Dy nënoficerë të lartë të FSK-së kanë përfunduar Kursin e Rreshter Majorëve në SHBA




SHBA, 30 qershor 2020. Radhëve të rreshter majorëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), të cilët kryen kursin e rreshter majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), më 19 qershor 2020, iu shtuan edhe Rreshter Majori i Komandës Bedri Zuka dhe Rreshter Master Rifadije Ramadani, të cilët përfunduan me sukses Kursin e Rreshter Majorëve në Qendrën e Ekselencës për Udhëheqje për Nënoficer në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht në Bazën Fort Bliss në El Paso në Teksas. Ky institucion më herët ka qenë i njohur si Akademia e Rreshter Majorëve. Kursi i Rreshter Majorëve është program 12- mujor, që përgatit rreshter major për principet e lidershipit, për udhëheqjen e trupës së nënoficerëve, për këshillimin e nivelit të lartë të oficereve lidhur me funksionimin e trupës së nënoficerëve, për ekzekutimin e operacioneve të përbashkëta tokësore, duke përfshirë të gjitha degët e ushtrisë amerikane si dhe operacionet ndërkombëtare në bashkëpunim me agjenci të ndryshme. Shkollimi i oficerëve të FSK-së, është mbështetur nga Zyra për Mbrojtje dhe Bashkëpunim pranë Ambasadës së SHBA-së në Kosovë. Rreshter Majori i Komandës Bedri Zuka dhe Rreshter Master Rifadije Ramadani gjatë shkollimit në Qendrën e Ekselencës për Udhëheqje për Nënoficer në SHBA, treguan disiplinë, angazhim dhe profesionalizëm, si dhe e përfunduan me sukses të lartë Kursin e Rreshter Majorëve, klasa 70. Diplomimi i dy rreshter majorëve në përgjithësi është një e arritur e radhës për FSK-në, ku deri më tani në këtë Akademi të Rreshter Majorëve kanë diplomuar me sukses të dalluar gjithsej shtatë oficerë të FSK-së.

FSK-ja nxjerr trupat e pajetë të minatorëve të Minierës së Artanës



2020. Ekipet e Kërkim-Shpëtimit të Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë të Kosovës, pas mesnate, kanë arritur të nxjerrin trupat e pajetë të dy minatorëve të Minierës së Artanës. Operacioni i nxjerrjes së trupave ka zgjatur disa orë, për shkak të specifikave të punës. Në operacion kanë marrë pjesë: FSK-ja, Policia e Kosovës, Zjarrfikësit, njësitet e kërkim-shpëtimit të minierave, si dhe institucione të tjera të sigurisë. Trupat e pajetë i janë dorëzuar institutit të mjekësisë ligjore për procedura të mëtutjeshme.

FSK-ja për herë të parë dërgon kadet në Akademinë e Forcave Ajrore të SHBA-ve



Prishtinë, 11 prill 2020. Forca e Sigurisë e Kosovës, që nga themelimi i saj për herë të parë, do të dërgojë kadet për tu shkolluar në Akademinë e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kadeti i përzgjedhur është Albin Bytyqi, dërgimi i tij në këtë akademi prestigjioze është pasqyrim i bashkëpunimit të ngushtë mes SHBA-ve dhe Republikës së Kosovës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si partner strategjik i FSK-së, në vazhdimësi ofrojnë mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së. Të gjitha testimet si dhe nominimet e kandidatëve, janë bërë në kuadër të bashkëpunimit të Ambasadës Amerikane me Kosovën dhe Forcën e ë Sigurisë së Kosovës. Kandidatët ju kanë nënshtruar testeve rigoroze, duke filluar nga Testi i Inteligjencës, Testi i gjuhës angleze ECL, Testi SAT si dhe Testi Fizik. Kadeti Albin Bytyqi, ka qenë kandidati i cili në bazë të përformances së testeve dhe kritereve tjera të përcaktuara, është përzgjedhur nga Akademia e Forcave Ajrore të SHBA-së për shkollim në kuadër të gjeneratës 2024.

FORCA JONË

••• Viti VIII • Nr. 91 • 2 Shtator 2020 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës •••

Kryeministri Avdullah Hoti vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Qendrën Mjekësore të FSK-së

Prishtinë, 28 korrik 2020. Kryeministri i Kosovës z. Avdullah Hoti së bashku me ministrin e Shëndetësisë z. Armend Zemaj kanë vizituar Qendrën Mjekësore të FSK-së në kazermën „Adem Jashari“ në Prishtinë. Kryeministri Hoti, së pari, u prit në mjediset e Ministrisë nga ministri Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, u.d. i sekretarit të përgjithshëm të MM-së, Faruk Geci, shefi i Kabinetit të Ministrit, Jashar Ramadani, si dhe stafi i lartë i Ministrisë dhe FSK-së. Ministri Anton Quni, pas i uroi mirëseardhje kryeministrit Hoti, e njoftoi edhe për gjendjen në të cilën e ka gjetur Ministrinë dhe FSK-në, punën e mirë që është bërë nga ministrat paraprak dhe angazhimet aktuale për tranzicionin e FSK-së, bazuar në ligjet e reja me mision të ri, që ka si Ministria e Mbrojtjes ashtu dhe FSK-ja, duke i kushtuar vazhdimisht rëndësi bashkëpunimit me partnerin strategjik SHBA-në, bashkëpunimet dypalëshe, bashkëpunimin e mirë me ekipin e NALT-it, i cili është i pranishëm si në Ministri ashtu edhe në Forcë. Për angazhimin e FSK-së, në kuadër të gjendjes së pandemisë COVID-19, ku FSK-ja ka dhanë kontribut në mbështetje të autoriteteve civile, me logjistikë, transport dhe me kapacitete për akomodim dhe trajtim në raste të përkeqësimit të gjendjes. Ndër të tjera, ministri Quni e njoftoi kryeministrin Hoti edhe me luftën speciale që po bëhet përmes mediave ruse,



se gjoja FSK-ja ka blerë armatim fshehurazi nga Gjermania në vlerë deri në 170 milionë Euro, të gjitha këto sipas ministri Quni bëhen për të destabilizuar paqen në Ballkan, dhe për të krijuar pretekst për armatosjen e mëtejme të Serbisë, si dhe duke tentuar të kompromet ojë bashkëpunimin tonë të mirë dhe transparent me Gjermaninë. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, e njoftoi kryeministrin Hoti me angazhimet konkrete të FSK-së, me planin e zhvillimit dhe transformimit, me trajnimet dhe shkollimet e ushtarëve dhe oficerëve të FSK-së në akademitë ushtarake të vendeve mike dhe partnere. Për menaxhimin e financave të FSK-së, buxhetin aktual dhe pajisjen me teknikë të nevojshme për të rritë operacionalitetin e FSK-së sipas planit të zhvillimit dhe ngritjes së FSK-së. Ai foli për takimin që ka pasur me ministrin e Shëndetësisë z..Armend Zemaj, për bashkëpunimin e mirë që ka Qendra Mjekësore e FSK-së me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me QSUK-në. Ndërkaq, kryeministri Hoti pasi i falënderoi për pritjen ministrin Quni dhe komandantin Rama, i përgëzoi ata edhe për punën e deritashme të FSK-së, si njëri ndër institucionet më të besueshëm në vend, që na bënë të ndihemi krenarë të gjithëve. Ai po ashtu shprehet se vlerësim të lartë për FSK-në ruajnë edhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët e kanë shfaqur shumë herë. Kryeministri, me këtë rast, shprehu gatishmërinë që në emër të qeverisë së tij, të jap mbështetjen e duhur pavarësisht rrethanave aktuale, për të punuar në zbatim dhe realizimin e planit të transformimit dhe ngritjeve të kapaciteteve të FSK-së. Gjatë vizitës në Qendrën Mjekësore të FSK-së, kryeministri Hoti u shoqërua nga ministri Zemaj, ministri Quni, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, u.d. i sekretarit të përgjithshëm të MM-së z. Faruk Geci dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Ai u prit nga përgjegjësi, major Adem Preteni, i cili prezantoi kapacitet e kësaj qendre, mjetet që posedojnë, dhomat e akomodimit në rast nevoje për të shtruar të sëmurët dhe kapacitet tjera që ka kjo qendër. Duke vlerësuar lart punën e FSK-së, në deklarimin para mediave, kryeministri Hoti, tha: „Inspektuam Spitalin Ushtarak për të parë nga afër kapacitetet e FSK-së, të cilat do t'i vëmë në dispozicion në rast nevoje. Unë nuk jam ushtarak, por jam i impresionuar dhe i emocionuar me disiplinën ushtarake. Do të punojmë së bashku me stafin për të përballuar situatën nëpër të cilën po kalojmë. I falënderova për mbështetjen që ka dhënë FSK-ja për institucionet tjera. Tash po duket se gjendja po përkeqësohet dhe ne duhet të përgatitemi për të gjitha variantet që i kemi përpara“. Më pastaj, kryeministri Hoti dhe delegacioni i tij, vizituan automjetet e HMMWV-së të rreshtuara në pistën e FSK-së. Në fund, ministri Quni u prononcua për media, ku me theks të veçantë foli për deklaratat e fundit të Rusisë dhe Serbisë për pajisjen e kësaj të fundit me armatim shtesë. Ministri Quni deklaroi se përkundër Serbisë e cila posedon kapacitete kërcënues, Kosova është e orientuar në kapacitete mbrojtëse, e ka buxhetin transparent, dhe ngritja e FSK-së është duke u bërë në koordinim me partnerin e saj strategjik SHBA-në dhe në transparencë të plotë me NATO-n. Ministri Quni përmendi edhe gatishmërinë e FSK-së për t'u angazhuar në misione paqësore në forcim të stabiliteti në rajon dhe më gjerë. Kosova nuk ka ambicie territoriale ndaj fqinjëve, ashtu si Serbia, e cila vazhdon ta ketë Kosovën ende në preambulën e kushtetutës së saj.



Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë



Tiranë, 23 korrik 2020. Me ftesë të homologut të tij, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama zhvilloi vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh midis FSK-së dhe FARSH-së. Agjendën e tij, gjeneral Rama me delegacionin shoqërues e filloi me vizitën në Ministrinë e Mbrojtjes, ku me ceremoni dhe nderimet më të larta ushtarake u prit nga homologu i tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku i shoqëruar nga stafi i tij më i lartë. Në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneral Rama, takimin e parë e zhvilloi me zëvendësministrin e Mbrojtjes z. Petro Koçi. Në fillim, zëvendësministri Koçi e njoftoi gjeneral Ramën me zhvillimet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, vlerësimin e lartë të nivelit të bashkëpunimit ndërministror dhe ndërushtarak me zotimin për thellim dhe zgjerim të mëtejmë të këtij bashkëpunimi. Duke shprehu falënderimin për ftesën dhe pritjen vëllazërore, gjeneral Rama vlerësoi lart mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe instancat tjera shtetërore për mbështetjen e deritashme në të gjitha aspektet me theks të veçantë në aspektin e diplomacisë ushtarake, ku si vend anëtare e NATO-s, Kartës së Adriatikut (A5) dhe iniciativave rajonale të sigurisë dhe mbrojtjes, ka ndikuar shumë në fuqizimin e pozicionit të Ministrisë sonë dhe FSK-së në strukturat përkatëse. Pastaj, gjeneral Rama zhvilloi takimin me homologun e tij me gjeneral Kollçakun. Në fillim të takimit, të dy gjeneralët informuan njëri – tjetrin lidhur me zhvillimet e përgjithshme aktuale të forcave, sfidave aktuale të shkaktuara nga kriza e pandemisë COVID-19 si dhe objektivat zhvillimor për të ardhmen. Takimi mes dy delegacioneve respektive kishte në fokus çështjet me interes të përbashkët, respektivisht vlerësimin e shkallës së realizimit të Planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh FSK-FARSH, aktivitetet në proces të realizimit si dhe ato të planifikuara për të ardhmen. Gjeneral Rama shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për mbështetjen e deritashme të FARSH-së në të gjitha fushat, duke ofruar edhe gatishmërinë për ofrimin e mbështetjes së ndërsjellë nga ana e FSK-së në fushat që vlerësohen nga ana e FARSH-së. Nga ana e tij, gjeneral Kollçaku, çmoi lart të arriturat e deritashme të FSK-së me theks të veçantë në aspektin e profesionalizimit të burimeve njerëzore dhe shkallës së operacionalitetit, të gjitha këto të dëshmuara me suksese të larta në të gjitha nivelet arsimore-stërvitore të përbashkëta në kuadër të akademive dhe stërvitjeve shumëkombëshe, si dhe në operacionet e realizuara. Në fund të dy u dakorduan për intensifikimin e bashkëpunimit në nivel të mbështetjes së ndërsjellë dhe në nivel të shkëmbimit të përvojave, aftësive dhe kapaciteteve në fushat me interes të përbashkët. Gjatë takimit gjeneral Kollçaku shoqërohej nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J-5/8), kolonel Bilbil Bitri, drejtor i kabinetit të tij, kolonel Arben Zani, oficeri i J5/8, nënkolonel Fredi Maksuti dhe këshilltari i tij politik, Perikli Koliqi. Në takim të veçantë, gjeneral Rama u prit edhe nga presidenti i Republikës së Shqipërisë shkëlqesia e tij Ilir Meta, i cili shprehu edhe njëherë admirimin e madh për FSK-në dhe besimin e plotë për perspektivën zhvillimore të saj të afërt në strukturat operacionale të NATO-s në misione paqeruajtëse, duke fuqizuar rolin e Kosovës në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e më gjerë. Gjeneral Rama ritheksoi mirënjohjen dhe falënderimin presidentit Meta për mbështetjen e tij të pandërprerë në të gjitha etapat e zhvillimit të forcave ushtarake të vendit nga të gjitha pozitat e tij të lidershipit shtetëror dhe besimin e plotë në rolin dhe angazhimin e njëjtë për FSK-në edhe në të ardhmen. Për këtë arsye edhe simbolikisht i dhuroi uniformën kamuflazh të FSK-së. Gjatë vizitës dhe takimeve gjeneral Rama u shoqërua nga atasheu i Mbrojtjes të Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, kolonel Bashkim Shillova, këshilltari ushtarak, nënkolonel Berat Shala, zyrtari për politika dhe marrëdhënie ndërinstitucionale, Ali Bajqinovci si dhe asistentja ushtarake, kapiten Manushaqe Nura.





FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ministri Quni raportoi para Komisionit Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes



Prishtinë, 22 korrik 2020. Në mjediset e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni raportoi para Komisionit Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes lidhur me zhvillimet e përgjithshme aktuale të FSK-së, sfidat si dhe objektivat zhvillimorë për të ardhmen. Ndër të tjera, ministri Quni foli edhe krizën e shkaktuar nga pandemia COVID-19 me fokus për luftimin e saj, duke u shprehur: "Ministria e Mbrojtjes dhe FSK ka arritur me sukses të realizojë pjesën më të madhe të aktiviteteve të planifikuara, në funksion të përmbushjes së objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe qeverisë në përgjithësi. Ai gjithashtu theksoi se, meqë jemi në vitin e dytë të procesit të tranzicionit të FSK-së në misionin e forcës ushtarake, edhe objektivat tanë janë të fokusuar në përmbushjen e aktiviteteve në përputhje me Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, gjithnjë në drejtim të arritjes së aftësive dhe kapaciteteve të plota operacionale deri në vitin 2027, kapacitete këto të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor". Pas ekspozesë së ministrit Quni, anëtarët e komisionit përkatës të kryesuar nga znj. Fatmire Kollçaku–Mulhaxha, parashtruan pyetjet me interes lidhur me statusin e projekteve kapitale të FSK-së në rishikimin buxhetor, gjendjen e pjesëtarëve në rrethanat e pandemisë COVID-19, idenë e shërbimit të obligueshëm ushtarak, rregulloren e pagave për pjesëtarët e FSK-së, procesin e integrimit të pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve joshumicë dhe sfidat në këtë proces, politikat konkrete në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, kapacitetet e diplomacisë ushtarake si dhe memorandumeve të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh .

Për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e komisionit, ministri Quni, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe u.d. i sekretarit të përgjithshëm z.Faruk Geci ofruan përgjigje me informacione të plota dhe të qarta duke përmbushur në mënyrë të plotë obligimin ligjor në funksion të transparencës dhe llogaridhënies së plotë para përfaqësueseve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si organ kushtetues i ushtrimit të kontrollit demokratik parlamentar mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministri Quni gjatë takimit shoqërohej edhe nga këshilltari i tij ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi dhe zyrtarja e lartë e kabinetit të tij, Martina Dedaj- Kçira.

Ministri Quni priti drejtorin e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent Fadil Kodra




Prishtinë, 7 korrik 2020. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni priti në takim drejtorin e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent z. Fadil Kodra. Ministri Quni e njoftoi z. Kodra për zhvillimet aktuale në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në FSK, si dhe për objektivat në të ardhmen. Temë kryesore e takimit ishte bashkëpunimi i ndërsjellë dhe koordinimi sa më mire i dy institucioneve në përgjegjësitë individuale dhe aktivitetet e përbashkëta në përballje me krizën e shkaktuar nga pandemia COVID-19. Nga ana e tij, z. Kodra shprehu vlerësimin e lartë për të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, dhe në veçanti për angazhimin, përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre të treguar në realizimin e detyrave në funksion të përballimit të situatës epidemiologjike në vend. Në vazhdim, ministri Quni dhe z. Kodra u dakorduan që të intensifikojnë bashkëpunimin e ndërsjellë në fushat e përbashkëta, që ndërlidhen në kuadër të Planit të Reagimit Kombëtar, si dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet AME-së dhe Gardës Kombëtare të FSK-së. Në fund, të dy u zotuan se me të gjitha aftësitë dhe kapacitetet operacionale që disponojnë janë të gatshëm t'u përgjigjen nevojave të autoriteteve shtetërore dhe të gjithë qytetarëve pa dallim, duke kërkuar edhe nga ta respektimin e plotë të masave anti-COVID-19. Gjatë takimit, drejtori Kodra shoqërohej nga shefi për bashkëpunim ndërkombëtar dhe çështje publike në AME z. Nehat Koçinaj.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet KK të Prishtinës, Humanity First dhe FSK-së

Prishtinë, 28 korrik 2020. Në mjedise e Qendrës Mjekësore të FSK-së, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet FSK-së, KK të Prishtinës dhe organizatës joqeveritare "Humanity First". Marrëveshja ka për qëllim pajimin me tunel dezinfektues për nevojat e FSK-së, ku do të bëhet i mundur dezinfektimi i personelit ushtarak dhe vizitorëve eventual, të cilët do ta frekuentojnë këtë kazermë. Sipas marrëveshjes, tuneli pritet të vendoset brenda javës në hapësirën që do ta përcaktojë Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së. Në emër të FSK-së marrëveshjen e nënshkroi drejtori i përgjithshëm i QMFSK-së, dr. Shkëlzen Sylaj.



Certifikohen pjesëtarët e





Prishtinë, 14 gusht 2020. Në Aeroportin e Gjakovës, Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) mbajti ceremoninë e përfundimit të trajnimit tremujor „Komando-Bereta“. Në ceremoni morën pjesë, Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni, zv. ministrja Sadika Kofrc, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në MM, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së. Në fillim, pjesëtarët që përfunduan trajnimin “Komando-Bereta”, demonstruan shkathtësitë e tyre në tri disiplina, si në: Arte marciale; qitje me tranzicion; dhe neutralizim të objektivit me rëndësi të lartë, të cilat u përcollën me vëmendje nga të gjithë mysafirët. Me këtë rast, ministri Quni, përgëzoi stafin dhe të gjithë pjesëtarët e trajnimit, duke u shprehur se: “Ju kemi përcjellë gjatë tërë kohës dhe jemi të njoftuar se jeni përballur me kushte të rënda atmosferike dhe marshime të gjata. Ky është programi i trajnimit nëpër të cilat duhet të kalojnë njësitë elite. Ju nesër do të merrni detyra. FSK-ja në përgjithësi do të ketë detyra të reja, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, gjithnjë në shërbim të stabilitetit dhe paqes. Ju do të jeni të parët që do të përballeni me rrezikun dhe të fundit që do të tërhiqeni. Ju jeni forca elite goditëse e FSK-së dhe po ashtu jeni forca mbrojtëse e FSK-së. Kjo nuk mbaron me kaq, ne dëshirojmë të ju shohim në misione paqeruajtëse krah për krah me ushtarë të miqve tanë ndërkombëtarë, të cilët po na përkrahin me programe dhe projekte të ndryshme, që ne të bindim komunitetin ndërkombëtar se nuk jemi faktorë rreziku për rajonin, por përkundrazi jemi faktorë të paqes dhe të sigurisë”. Ministri Quni përmbylli fjalën e tij duke ju uruar suksese të reja të gjithë ushtarëve si njësi dhe secilit personalisht në realizimin e detyrave. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama, në fjalën e tij u shpreh i kënaqur me realizimin e këtij trajnimi dhe me rezultatet e treguara të pjesëtarëve të FSK-së. Ai, pos tjerash tha: „Ne jemi ata që përcaktojmë se si do të duket ushtria jonë. Ne jemi ata që duke vendosur standarde të larta

Njësisë Komando-Bereta







në të gjitha fushat, shtrojmë rrugën për gjeneratat e reja, dhe bëhemi shembull se si duhet të ecim përpara. Me këtë trajnim, Ju jeni bërë shembull shumë i mirë i kësaj. Gjatë këtij trajnimi, ju treguat performancë, angazhim dhe përkushtim të lartë. Dhe kështu keni vendosur standard jashtëzakonisht të lartë për gjeneratat e ardhshme. Unë ju përgëzoj për këtë. Me lejoni që të falënderoj dhe përgëzoj edhe oficerët dhe nënoficerët që e mundësuan këtë trajnim. Profesionalizmi që treguar gjatë këtij trajnimi mjaft të vështirë dhe kompleks, tregon që FSK-ja ka avancuar shumë, dhe është e aftë të konceptojë, të dizajnojë dhe të kryejë trajnime edhe më komplekse". Në fund të ceremonisë, për kursantët të cilët përfunduan me sukses trajnimin dhe për instruktorët që mundësuan realizimin e tij, u ndanë certifikatat dhe „Beretat e Gjelbra".

Ministri Anton Quni priti kryetaren e Parlamentit zonjën Vjosa Osmani

Prishtinë, 12 gusht 2020. Ministri i Mbrojtjes z.Anton Quni i shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, u.d. i sekretarit të përgjithshëm i MM-së z. Faruk Geci, pritën sot në një vizitë pune, kryetaren e Kuvendit të Kosovës, znj. Vjosa Osmani të shoqëruar nga stafi i saj. Ministri Quni pasi i uroi mirëseardhje kryeparlamentares Osmani, e njoftoi atë me aktivitetet që po zhvillohen në Ministrinë e Mbrojtjes, me procesin e transformimit të FSK-së, arritjet e deritashme dhe sfidat. Ministri Quni, me këtë rast, foli për punën që është bërë, deri më tash, në hartimin e dokumenteve nënligjore, pas aprovimit të ligjeve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, me mision të ri, për të gjitha fushat dhe nivelet që garantojnë funksionalizim institucional dhe ligjor të FSK-së. Ministri Quni, gjithashtu e njoftoi kryeparlamentaren Osmani edhe për bashkëpunimin e mirë që ka Ministria dhe FSK-ja me partnerin strategjik SHBA-në, bashkëpunimet dypalëshe, bashkëpunimin me KFOR-in, bashkëpunimin e mirë me ekipin e NALT-it, që është prezentë në Ministri dhe Forcë, duke vlerësuar se është rritur besueshmëria me partnerët ndërkombëtarë. Ministri Quni, gjithashtu theksoi se në kuadër të plotësimit të infrastrukturës ligjore dhe të dokumenteve të rëndësishme të fushës së sigurisë, është



prioritet procedimi i Strategjisë së Sigurisë të Kosovës e cila i hap rrugë procedimit të Strategjisë së Mbrojtjes. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij, foli për planin e transformimit të FSK-së, duke nënvizuar rezultatet e arritura deri më tash përballë gjendjes së rënduar nga pandemia, përshtatjes me këtë gjendje dhe kryerjes së detyrave të planifikuara. Ai, po ashtu, foli edhe për rezultatet e mira që kanë arritur kadetët në akademitë më të njohura në botë, si në: West Poent-SHBA, Mbretëri të Bashkuar, Gjermani, Kroaci, Turqi, Maqedoni etj. Gjeneral Rama, e njoftoi znj. Osmani edhe lidhur me kontributin e FSK-së në menaxhimin e situatës me pandeminë COVID-19, si brenda FSK-së ashtu edhe në mbështetje të institucioneve mjekësore si me logjistikë, me transport dhe me kapacitete të tjera shtesë Nga ana e saj, kryeparlamentarja Osmani, duke e falënderuar për pritjen e ngrohtë, vlerësoi lart arritjet e FSK-së, duke shtuar se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja janë dy institucione që vlerësohen edhe në Parlamentin e Kosovës. Ajo nënvizoi angazhimin dhe kontributin e FSK-së në menaxhimin e situatës së pandemisë në ndihmë të qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës. Zonja Osmani premtoi se aty ku ka nevojë FSK-ja do ta ketë mbështetjen e përhershme dhe të pa rezervë të Kuvendit të Kosovës. Gjatë takimit u bisedua edhe për incidentin në Karaqevë të Kamenicës, për veprimtarinë e xhandarmerisë serbe, e cila i ka revoltuar banorët lokalë. Kryeparlamentarja u shpreh se në raste të tilla duhet të ketë informim më të shpejtë, transparencë dhe koordinim me të mirë ndërmjet institucioneve shtetërore, në mënyrë që kemi prani më të shpejtë ndërkombëtare dhe ndërhyrje të institucioneve përkatëse në situata të tilla. Me vlerësimin e dyanshëm në takim u vendos për dërgimin e një oficeri ndërlidhës në Kuvendin e Kosovës, me qëllim të lehtësimit të komunikimit mes Ministrisë dhe FSK-së me Parlamentin. Në kuadër të vizitës, kryeparlamentarja Osmani qëndroi edhe në Qendrën Operative të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, ku nga shefi i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, u njoftua me angazhimet operacionale të FSK-së.



Ministri Anton Quni priti në takim zëvendësministrat nga radhët e komunitetit egjiptian



Prishtinë, 10 gusht 2020. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni i cili shoqërohej nga zëvendësministri i Mbrojtjes Muhamedali Mergjollari, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe këshilltari i tij ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi, priti në takim zv. ministrin e Infrastrukturës z. Artan Berisha, zv. ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale z. , Bashkim Krasniqi dhe deputetin e Kuvendit të Kosovës z. Veton Berisha. Në fokus të këtij takimi ishte procesi i integrimit të të gjitha komuniteteve në FSK dhe në veçanti i komunitetit egjiptian, të arriturat dhe sfidat e FSK-së në këtë proces. Ministri Quni, në filim, i njoftoi mysafirët me zhvillimet aktuale të Ministrisë dhe FSK-së, të arriturat e përgjithshme, objektivat për të ardhmen, angazhimet rreth procesit të integrimit të pjesëtarëve të FSK-së, nga radhët e komuniteteve joshumicë, si detyrë e domosdoshme dhe e natyrshme e vizionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Duke vlerësuar lart angazhimin e pjesëtarëve të FSK-së nga komuniteti egjiptian, ai kërkoi nga zëvendësministrat që të japin kontributin e tyre në fushatën informuese dhe motivuese për aplikimin e sa më shumë të rinjve nga radhët e komunitetit egjiptian dhe komuniteteve të tjera, duke theksuar se FSK-ja është e të gjithë qytetarëve të vendit dhe në shërbim të të gjithëve, pa dallime etnike, fetare, racore e kulturore. Zv. ministri Berisha, gjatë takimit shprehu vlerësimin e lartë për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, dhe me theks të veçantë u ndalë rreth mundësisë së shtimit të radhëve të të rinjve nga radhët e komunitetit egjiptian dhe të komuniteteve të tjera në FSK. Ata u zotuan se do të angazhohen maksimalisht në inkurajimin e të rinjve nga radhët e komunitetit të tyre që të aplikojnë në FSK. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i njoftoi të pranishmit me konkursin si dhe interesimin e të rinjve për t'u bërë pjesë e FSK-së. Gjeneral Rama tha se jemi të interesuar t'i shtojmë radhët e FSK-së me pjesëtarë nga të gjitha komunitetet, e në rastin konkret edhe nga komuniteti egjiptian, duke i inkurajuar për konkurrim sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara.

Drejtori i QM të FSK-së, dr. Shkëlzen Sylaj priti drejtorin e SHSKUK-së, dr. Valbon Krasniqin



Prishtinë, 28 korrik 2020. Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dr. Valbon Krasniqi vizitoi sot, Qendrën e Mjekësisë të FSK-së, ku u prit nga drejtori, dr. Shkëlzen Sylaj. Takimi i drejtorëve të dy institucioneve shëndetësore SHSKUK–QMFSK-së u realizua me qëllim të thellimit të bashkëpunimit institucional. Drejtori i SHSKUK-së, dr. Krasniqi, gjatë vizitës u njoftua nga drejtori i QMFSK-së dr. Sylaj me kapacitetet në pajisje dhe personel të shërbimit spitalor të Qendrës Mjekësore të FSK-së. Drejtorët Sylaj dhe Krasniqi biseduan edhe për gjendjen e përgjithshme të epidemisë COVID-19, si dhe për format e thellimit të bashkëpunimit mes të dy institucioneve. Ndërsa, Dr. Krasniqi, në fjalën e tij, tha se ndihet i privilegjuar dhe që ka emocione dhe ndjenjë të veçantë gjatë qëndrimit në Qendrën e Mjekësisë të FSK-së, duke shtuar se vizita në këtë qendër është frymëzim për vazhdim të punës si mjek, dhe njëherësh premtoi që do të angazhohet për zbatimin pikë për pikë të marrëveshjes mes dy institucioneve. Në takim u bisedua edhe për hapësirat dhe kapacitetet që ka QMFSK-ja dhe mundësinë e mbështetjes me staf mjekësor nga ana e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

Ekipet mjekësore të FSK-së u bashkohen stafit mjekësor të QKUK-së



Prishtinë, 24 gusht 2020. Pas trajnimit specifik për përballje me pandeminë COVID-19, stafit mjekësor të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës iu bashkuan tri ekipe mjekësore në përbërje prej 12 infermierëve nga Forca e Sigurisë e Kosovës. Ky kontingjent profesional i FSK-së do të shërbejë në kuadër të sistemit menaxherial të QKUK-së dhe do t'ia lehtësojë shumë punën stafit të Klinikës Infektive, pas angazhimit të sforcuar të tyre dhe nevojës së domosdoshme për staf shtesë gjatë periudhës së shfaqjes së pandemisë në vendin tonë. Të pranishëm në ceremoninë e fillimit të angazhimit të ekipeve mjekësore të FSK-së, përveç drejtorit të QMFSK-së, dr. Shkëlzen Sylaj, ishin edhe ministri i Shëndetësisë z. Armend Zemaj dhe u.d. i drejtorit të përgjithshëm të SHSKUK-së dr.Valbon Krasniqi. Nga ana e tij, dr. Krasniqi, vlerësoi lart mbështetjen e ofruar në këtë formë nga ana e FSK-së, duke shprehur besimin e plotë në shkathtësitë dhe profesionalizmin e dëshmuar në të gjitha aktivitetet dhe ndihmën konkrete tani ndaj pandemisë COVID-19. "Kam shumë besim në profesionalizmin tuaj. Shkëmbimi i përvojave tuaja do ta ndryshojë mozaikun e plotë për shërbime sa më kualitative për pacientët tanë", ka deklaruar Krasniqi. Nga ana e tij, ministri Zemaj, theksoi se përmes këtij bashkëpunimi do të fuqizohet lufta kundër pandemisë COVID-19. "Bashkëpunimi ndërinstitucional për ta luftuar pandeminë po i jep rezultatet e veta. Në momente të vështira kemi pranë djemtë dhe vajzat e FSK-së, që janë të gatshëm për t'u vënë plotësisht në shërbim të qytetarëve.", tha ndër të tjera ministri Zemaj. Sipas drejtorit të Qendrës Mjekësore të FSK-së dr. Shkëlzen Sylaj, ekipe të ngjashme mjekësore të FSK-së janë duke u përgatitur për mbështetjen edhe të qendrave spitalore rajonale të vendit. Që nga marsi kur janë paraqitur rastet e para me COVID-19, FSK në kuadër të detyrës së saj ligjore për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile, ka ngritur gjendjen e gatishmërisë në nivelin 2 dhe ka realizuar aktivitete të shumta me aftësitë dhe kapacitetet e saj operacionale në dispozicion.

Ministri Anton Quni ndjek nga afër zhvillimin e stërvitjeve fushore të njësiteve të KFT-së



Prishtinë, 6 gusht 2020. Ministri i Mbrojtjes z. .Anton Quni së bashku me gjeneral-majorin Enver Cikaqi dhe stafin e tij, kanë ndjekur nga afër zhvillimin e stërvitjes fushore "Kompania në mbrojtje", të realizuar nga Kompania A3 e Regjimentit të Tretë të Forcave Tokësore të FSK-së,në Zonën e Qyqavicës. Po ashtu, ministri Quni vizitoi edhe pjesëtarët gjatë demonstrimit praktik të trajnimit „Komando-Bereta", që është duke u realizuar në zonën e fshatit Ceceli të Komunës së Vushtrrisë. Për zhvillimin, objektivat e synuar të stërvitjes dhe trajnimit përkatës si dhe kapacitetet njerëzore e teknike të angazhuara, ministrin Quni e njoftoi komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral Fadil Hadërgjonaj. Nga ana e tij, ministri Quni e përgëzoi KFT-në, duke e vlerësuar lart angazhimin e saj edhe në këtë kohë pandemie, për organizimin e trajnimeve dhe stërvitjeve të formateve të tilla, duke treguar nivel të lartë disipline e profesionalizmi për arritjen e aftësive taktike operuese për realizimin e misionit dhe detyrave specifike të Komandës së Forcave Tokësore dhe FSK-së në përgjithësi. " Unë kam marrë raportet e përditshme të punës dhe angazhimit tuaj dhe jam i vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat keni kaluar gjatë kësaj periudhe, por me moral të lartë, kalitje fizike dhe shkathtësitë e duhura profesionale keni arritur t'i përballoni me sukses", tha ndër të tjera ministri Quni. Trajnimi "Komando-Bereta" është duke vijuar, dhe është trajnim në kuadër të planit vjetore të trajnimeve sipas planit të tranzicionit për ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen territoriale të vendit.





Nëntogeri Kushtrim Hoxha diplomon në Kursin Bazik për Artileri në Turqi



Prishtinë, 16 korrik 2020. Nëntogeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) Kushtrim Hoxha, pas përfundimit të Kursit Bazik për Artileri, nga data 13.01.2020 e deri më 13.07.2020, në mesin e 382 kursantëve, diplomoi me suksës të lartë në Shkollën e Artilerisë dhe Raketave në Polatli të Turqisë. Në këtë kurs ishin gjithsej edhe 17 kursantë të huaj nga të cilët oficer Hoxha zuri vendin e 3-të dhe mori Medaljen e Bronztë. Gjithashtu, nëntoger Hoxha për përkushtimin dhe mesataren e lartë të arritur gjatë kursit u zgjodh „Oficer Kursi Shembullor". Nëntoger Hoxha ka ndjekur edhe ligjërata të ndryshme gjatë kursit, të cilat vlerësohen si shumë të rëndësishme për profesionalizimin dhe rritjen e kapaciteteve të FSK-së. Ky sukses i nëntoger Hoxhës dhe oficerëve tjerë të FSK-së, që po shkollohen kudo në botë, janë me rëndësi për ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin e FSK-së, në funksion të përmbushjes së misionit të ri si forcë ushtarake dhe detyrave ligjore të saj.

FSK-së i shtohen edhe dy inxhinier të fluturimit





Prishtinë, 27 gusht Pas studimeve efektive në Akademinë e Aviacionit Tokësor në Isparta të Republikës së Turqisë, nënoficerët e FSK-së, Behar Zeqiri dhe Labinot Gashi, kanë përfunduar me sukses të lartë studimet themelore të aviacionit duke diplomuar me titullin "Inxhinierë të Fluturimit". Studimet kanë qenë të fokusuara në sistemet e helikopterit UH1-H dhe aeroplanit T182-T si dhe sisteme të tjera bashkëkohore të aviacionit tokësor. Pas diplomimit të tre pilotëve, Njësisë Ajrore të FSK-së i shtohen edhe këto kuadro të specializuara dhe shumë të rëndësishëm për ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të aviacionit të FSK-së. Akademia e Aviacionit Ushtarak është komponentë e Komandës së Trajnimit dhe Doktrinës së Forcave të Armatosura të Turqisë.

Nëntogeri Bener Paçarizi diplomoi në Shkollën e Xhenios Luftarake të Forcave të Armatosura të Turqisë



Prishtinë, 7 korrik 2020. Në Komandën e Shkollës së Xhenios Luftarake të Forcave të Armatosura të Turqisë në Izmir, pas shkollimit 6-mujor, prej datës 13 janar deri më 3 korrik 2020, oficeri i FSK-së, nëntoger Bener Paçarizi ka përfunduar me sukses Kursin Bazik për Xhenio Luftarake. Në kursin përkatës gjashtëmujor, nëntoger Paçarizi diplomoi me sukses në mesin e 120 kursantëve, ku përveç kursantëve nga vendi pritës, kursin e ndoqën edhe 13 kursantë nga 7 vende të ndryshme të botës. Ky sukses është edhe një vlerë e shtuar në kapacitetet e FSK-së me kuadro të nevojshme të specializuara për ngritjen dhe avancimin e aftësive profesionale në funksion të përmbushjes së misionit të ri si forcë ushtarake dhe detyrave ligjore të saj.

Në FSK bëhet pranim – dorëzimi i një donacioni me veshmbathje nga Turqia në vlerë prej 742,904.00$.





Prishtinë, 7 gusht 2020. Në mjediset e kazermës „Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, u mbajt ceremonia e pranim-dorëzimit të një donacioni nga Republika e Turqisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në vlerë financiare prej 742,904.00$. Ky donacion ka në përbërje: veshmbathje dhe shtretër fushorë si dhe pajisje tjera teknike. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm edhe komandanti i Komandës së Logjistikës të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri, atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovë, koloneli Ismail Cenkeri Ersoz dhe drejtori i Departamentit të Logjistikës në MM, kolonel Mentor Zejnullahu. Pas nënshkrimit të dokumenteve, gjenerali Naim Haziri ka falënderuar Qeverinë e Turqisë si dhe atasheun ushtarak për përkrahjen e vazhdueshme të FSK-së.

FORCA JONË

••• Viti VIII • Nr. 92 • 2 Tetor 2020 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës •••

Ministri Anton Quni u prit me nderime të larta ushtarake nga ministri i Mbrojtjes i Turqisë



Turqi, 29 shtator 2020. Ministri i Mbrojtjes z.Anton Quni, në kuadër të vizitës zyrtare në Republikën e Turqisë, në selinë e Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, me protokollin më të lartë shtetëror dhe me ceremoni të lartë ushtarake, u prit në takim nga homologu i tij dhe njëherësh nikoqiri, ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, Hulusi Akar. Dy ministrat zhvilluan takim kokë më kokë, për të vazhduar më pas kryesimin e takimit ndërmjet dy delegacioneve. Gjatë këtij takimi, ministri Akar theksoi miqësinë ndërmjet Turqisë dhe Kosovës në përgjithësi dhe partneritetin e fuqishëm ndërmjet dy ministrive dhe forcave në veçanti. Ai theksoi, nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të mira ndërmjet dy vendeve, ministrive dhe forcave si dhe rëndësinë e bashkëpunimin në të mirën e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë. Në takim u diskutua lidhur me bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe në fushën e industrisë së mbrojtjes. Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Anton Quni, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e madh të shtetit, qeverisë dhe Forcave të Armatosura të Turqisë në ndërtimin dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit tonë, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës. Ndër të tjera, ministri Quni, ritheksoi se partneriteti me Republikën e Turqisë si vend shumë i rëndësishëm i NATO-s, Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare dhe Forcat e Armatosura të Turqisë do të vazhdojë të jetë i fuqishëm në perspektivën tonë zhvillimore për të arritur aftësitë, kapacitetet dhe standardet më të larta operacionale për ofrimin e shërbimit tonë ndaj paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Gjatë takimit, me ministrin Akar dhe delegacionin e tij, ministri Quni shoqërohej nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Ankara, Ilir Dugolli, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, shefi i Kabinetit të Ministrit, Jashar Ramadani, atasheu ushtarak në Ankara, kolonel Bekim Osmani dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ushtarak dhe Integrime Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha. Vizita katër ditore e ministrit Quni dhe delegacionit të tij u realizua me ftesë të ministrit Akar, dhe do të vazhdojë me aktivitete të tjera me strukturat udhëheqëse të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, Forcave të Armatosura dhe industrisë së mbrojtjes.



Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 16 shtator 2020. Në mjediset e Parlamentit të Republikës së Kosovës, sot është mbajtur ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në prani të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe autoriteteve tjera të larta nga dy institucionet respektive, marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit e nënshkruan ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani – Sadriu. Sipas kësaj marrëveshjeje, ministri i Mbrojtjes në bashkërendim me komandantin e FSK-së emëron oficerin / zyrtarin ndërlidhës legjislativ mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të rritjes së bashkërendimit dhe komunikimit në përmbushjen dhe realizimin e detyrave kushtetuese dhe ligjore. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, kryetarja Osmani, ministri Quni dhe gjeneral Rama, shprehen gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejmë në të gjitha fushat e interesit të ndërsjellë. Në përmbyllje të ceremonisë, ministri Quni prezantoi para kryetares Osmani, oficerin ndërlidhës, kapiten Manushaqe Nura. Në ceremoninë përkatëse morën pjesë edhe këshilltari i ministrit të Mbrojtjes, Demokrat Gjocaj, këshilltari ushtarak i komandantit të FSK-së, nënkolonel Berat Shala, drejtori i Departamenti Ligjor në Ministrinë e Mbrojtjes, Krenare Dërmaku - Sogojeva, dhe këshilltari legjislative nga SHBA, znj.Katherine Barton.



Ministri i Mbrojtes Anton Quni priti kryerabinin e Shqipërisë dhe të Kosovës, Yoel Kaplan



Prishtinë, 15 shtator 2020. Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, i shoqëruar nga komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti sot në vizitë delegacionin e Kryerabinatit të Shqipërisë dhe Kosovës, kryesuar nga kryerabini Yoel Kaplan. Me këtë rast, ministri Quni shprehu falënderimin dhe vlerësimin e lart për vizitën e parë të kryerabinatit në Ministrin e Mbrojtjes, pas deklarimit zyrtar të njohjes së Republikës së Kosovës nga ana e Izraelit. Ministri Quni, theksoi se populli i Kosovës, ndër vlerat më unike të saj ka respektin tradicional ndaj të gjitha besimeve dhe se diversitetin fetar e kultivon ndër breza si pasuri të saj të paprekshme. Ky realitet është dëshmuar gjatë gjithë historisë, e konkretisht edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore kur paraardhësit tanë strehuan dhe vunë nën mbrojtje me "besën shqiptare" hebrenjtë nga fushata shfarosëse naziste. "Historia e popullit hebre për ne është e njohur sepse ka shumë të përbashkëta me të kaluarën e dhimbshme, por të lavdishme të popullit tonë" tha ministri Quni. Nga ana e tij, kryerabini Kaplan, shprehu falënderimin për pritjen miqësore dhe vlerësoi lart vendimin e kryeministrit izraelit për njohjen e shtetit të Kosovës, duke besuar se vonesën e deritashme ta kompensojmë me zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunim të thellë në të gjitha fushat. "Gjithmonë kam pasur besim në të ardhmen tuaj të ndritur duke pasur parasysh rininë tuaj inteligjente. Do të jemi me ju në rrugëtimin tuaj për të ardhmen", theksoi z. Kaplan. Duke shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e deritashëm të shtetit të Izraelit dhe popullit të tij për mbështetjen e deritashme për Kosovën të kurorëzuar edhe me njohjen zyrtare, ministri Quni dhe gjeneral Rama shprehën interesimin për zhvillimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes në nivel të ministrive dhe forcave respektive. Ata vlerësuan lart aftësitë dhe kapacitetet ushtarake të Izraelit si dhe eksperiencën e tyre në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes të nevojshme në stadin aktual të zhvillimit të FSK-së. Me këtë u pajtuan plotësisht të dy palët, duke besuar se kjo do të ndodh së shpejti me zyrtarizmin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes dy shteteve. Kryerabini Kaplan, gjatë vizitës shoqërohej edhe nga rabini i Tiranës, Yisroel Ivan Finman, sekretari i Kryerabinatit të Shqipërisë Geront Selenica dhe kryetari i Bashkësisë Hebreje "Bet Israel Kosova", Ruzhdi Shkodra.



Kosova në Konferencën e Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Evropës Qendrore

Prishtinë, 16 shtator 2020. Me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë, si nikoqir, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes i Republikës së Kosovës z. Faruk Geci dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrime Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha, morën pjesë në punimet e Konferencës vjetore të Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Evropës Qendrore (The Central European Defence Cooperation - CEDC). Bashkëpunimi Evropian Qendror i Mbrojtjes (CEDC) është iniciativë e bashkëpunimit ushtarak i përbërë nga shtetet e Evropës Qendrore si: Austria, Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria, Sllovenia, Kroacia dhe Polonia me status vëzhguesi. Objektivi i përbashkët i kësaj iniciative është rritja e bashkëpunimit të mbrojtjes, duke përfshirë bashkimin dhe ndarjen e aftësive mbrojtëse të vendeve anëtare si dhe organizimin e trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta. Kosova këtë radhë u ftua së bashku me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, pasi që sesioni i sivjetshëm i konferencës u fokusua në identifikimin e rrugëve të mundshme



për një dialog të zgjeruar të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së (Common Security and Defence Policy - CSDP - EU) me vendet e Ballkanit Perëndimor. Brenda kësaj teme u vlerësuan edhe nevojat nga pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor dhe u identifikuan format e bashkëpunimit në të ardhmen në formatin CEDC +, me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të partnerëve. Z. Geci dhe kolonel Hoxha gjatë ekspozesë së tyre, nga perspektiva e Ministrisë së Mbrojtjes prezantuan sistemin e integruar të menaxhimit të krizës në Kosovë, respektivisht procesin e planifikimit, gatishmërisë dhe ekzekutimin e operacioneve dhe masave kundër Covid-19, në kuadër të reagimit të përbashkët ndërinstitucional, me fokus në aftësitë dhe kapacitetet e angazhuara të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ata vlerësuan lart mbështetjen nga BE dhe vendet e tjera partnere si dhe shprehën gatishmërinë e plotë për bashkëpunim me vendet e rajonit dhe vendet e tjera në ndarjen e përvojave si dhe gatishmërinë për të kontribuar me pjesëmarrje konkrete në operacionet e përbashkëta kundër pandemisë dhe fatkeqësive tjera. Ata nënvizuan nevojën për një dialog të zgjeruar të Politikave të Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së me Ballkanin Perëndimor, duke vlerësuar misionet e BE-së dhe të NATO-s në rritjen dhe konsolidimin e sigurisë rajonale. Z. Geci shprehu besimin se Kosova është tashmë në fazën kur mund të ofrojë kontributin e saj, veçanërisht në fushën e emergjencave civile dhe gatishmërinë të mbështesë vendet e rajonit në rast krizash. "Tërmeti i vitit të kaluar në Republikën e Shqipërisë dëshmoi nevojën në rritje për bashkëpunim rajonal në reagim të përbashkët dhe Kosova ritheksoi gatishmërinë për të bashkëpunuar me strukturat e BE-së ose ato rajonale të mbrojtjes për t'i mbështetur ato në raste të emergjencave humanitare", tha ndër të tjera z. Geci. Lidhur me bashkëpunimin me institucionet e mbrojtjes së BE-së, z. Geci theksoi se Kosova i jep përparësi anëtarësimit në BE dhe natyrisht, Ministria e Mbrojtjes, si të gjitha institucionet e tjera të Republikës së Kosovës, synon të zhvillojë dhe përafrojë bazën ligjore me atë të BE-së, krahas vazhdimit të ndërveprimit brenda Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Bashkëpunimin në të ardhmen në formatin CEDC + me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të partnerëve të Ballkanit Perëndimor, përfaqësuesit tanë e vlerësuan shumë të rëndësishëm krahas mbështetjes për ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të FSK-së në këtë kontekst si dhe zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta me aktorë rajonalë dhe evropianë. Prezantimet e z. Geci dhe kolonel Hoxhës, u përcollën me interesim dhe u vlerësuan lart nga ana e pjesëmarrësve. Për shkak të kufizimeve të krijuara nga masat kundër Covid-19, konferenca u realizua përmes platformës së video-konferencës.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni priti grupin e grave nga Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës



Prishtinë, 15 shtator 2020. Me ftesë të ministrit të Mbrojtjes z. Anton Quni, sot në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes dhe kazermës së FSK-së "Adem Jashari" në Prishtinë ishin për vizitë një grup i grave të Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës kryesuar nga koordinatori, Mustafë Prenku. Grupi i grave vizitore kryesisht ishin nga punëtoria e shoqatës përkatëse me seli në Fushë Kosovë, e cila merret me rrobaqepësi dhe bizhuteri, punë dore. Duke iu shprehur mirëseardhje, ministri Quni i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, shprehu respektin dhe konsideratën më të lartë si një ndër shembujt më të mirë të organizimit si shoqatë dhe angazhimin e tyre që me punë dore të mbajnë veten dhe familjet e tyre. "Ju me shembullin tuaj jeni bërë zëri i ndërgjegjes sonë institucionale dhe qytetare, andaj për këtë meritoni nderimin dhe respektin më të lartë", tha ai. Nga ana e tij, gjeneral Rama, shprehu gatishmërinë e plotë për përkrahje ndaj shoqatës, me të gjitha kapacitetet e FSK-së në dispozicion. "Ashtu siç kemi detyrim ligjor për të gjithë qytetarët e vendit, për ju dhe kategoritë tjera të dala nga lufta, kemi edhe detyrim moral për të qenë pranë jush me të gjitha mundësitë tona". Pas takimit, grupi vizitorë u shoqërua nga ministri Quni dhe stafi i tij, në drekën e përgatitur në kazermën "Adem Jashari" duke përfunduar me prezantimin për historikun, strukturën, misionin dhe perspektivën zhvillimore të FSK-së. Përfaqësuesi i shoqatës dhe gratë vizitore shprehën emocionet dhe përshtypjet më të larta, falënderimin për ftesën dhe vizitën e realizuar duke pohuar se kjo është ftesa e parë që atyre u është bërë nga një institucion publik dhe udhëheqja e tij



Ministri Anton Quni priti kryeshefen ekzekutive të Postës së Kosovës znj. Vjollca Mulaj

Prishtinë, 02 shtator 2020. Ministri i Mbrojtjes, .Anton Quni, priti në takim u.d. kryeshefen ekzekutive të Postës së Kosovës znj.Vjollca Shala- Mulaj me bashkëpunëtorë, në vazhdën e takimeve të tyre me bartësit e institucioneve të vendit. Znj. Mulaj shprehu falënderimin për pritjen dhe e njoftoi ministrin Quni me të arriturat e deritashme dhe sfidat aktuale të Postës së Kosovës. Gjithashtu, ajo e njoftoi ministrin edhe me shërbimet postare, veprimtarinë postare dhe të arriturat e filatelisë së Kosovës. Nga ana e tij, ministri Quni falënderoi znj. Mulaj për shërbimet e deritashme dhe vlerësoi të nevojshme rritjen e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në temat e interesit të ndërsjellë institucional. Znj. Mulaj gjatë takimit shoqërohej edhe nga zëvendësja e saj, Fakete Kadiu dhe drejtori i Drejtorisë së shitjes, Burim Geci, kurse ministri Quni shoqërohej nga shefi i kabinetit të tij, Jashar Ramadani, zyrtarja e lartë e kabinetit, Martina Dedaj- Kqira dhe drejtori i Departamentit të KTI, Beqir Bytyqi.



Betohen kadetët - studentët e gjeneratës - 24



Prishtinë, 25 shtator 2020. Në mjediset e kazermës "Adem Jashari", u mbajt ceremonia ushtarake e betimit të kadetëve – studentë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve 2020 - 2024. Në ceremoninë e organizuar, me pjesëmarrje të kufizuar për shkak të masave kundër COVID-19, morën pjesë zv. ministrja e Mbrojtjes, Sadika Kofrc, zv. ministri i Mbrojtjes, Muhametalli Mergjollar, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zv. komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Frank Best, stafi tjetër i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, oficerë të NALT-it, këshilltarët ushtarakë bilateralë, si dhe familjarë të kadetëve – studentë të rinj. Me protokollin e ceremonisë ushtarake, me fjalë përshëndetëse dhe mesazhe urimi, kadetëve-studentë të rreshtuar, stafit drejtues dhe akademik të QSU-së dhe të pranishmëve tjerë, iu drejtuan, nikoqiri i ceremonisë, zv. komandanti i QSU-së, kapiten Lirim Bllaca dhe gjeneral Rama, kurse për shkak të angazhimeve tjera jashtë vendit, u lexua letra përshëndetëse me mesazhe urimi e dërguar nga ministri i Mbrojtjes, Anton Quni. Në fjalën e tij, gjeneral Rama, përveç urimeve, theksoi se rrugëtimi i nisur për të realizuar arritjen e standardeve më të larta profesionale dhe akademike do të realizohet me programin tejet sfidues për përgatitje psikike, fizike, profesionale dhe intelektuale. "Sot, Ju do të betoheni para flamurit, prindërve dhe udhëheqësve tuaj, se do të jeni të përkushtuar ndaj vendit, duke pasur gjithmonë parasysh moton e ushtarakut: Detyra, Nderi, Atdheu", tha ai. Gjeneral Rama, vlerësoi lart të arriturat e QSU-së për 15 vjet me radhë, në funksion të ndërtimit të forcave moderne, profesionale, shumetnike, të disiplinuar dhe të trajnuar sipas standardeve të ushtrive perëndimore së bashku me partnerët tanë strategjikë. Ndër të tjera, kadetët e rinj i inkurajoi që ta sfidojnë vetveten sa më shumë dhe ta mbrojnë njëri- tjetrin. "Të qëndroni të bashkuar, Një për të gjithë, e të gjithë për një!", porositi në fund gjeneral Rama. Ndërkaq në letrën e tij dërguar kadetëve –studentëve të rinj, ministri Quni çmoi lart ata, duke i vlerësuar si "E tashmja dhe e ardhmja e forcave tona, si dhe më të mirët prej më të mirëve". Ai kërkoi nga ta, përkushtim të madh gjatë studimeve, duke i këshilluar që shpirti i tyre patriotik të udhëhiqet nga vlerat e larta morale, ndërsa profesionalizmi i tyre të jetë qëllimi më i lartë gjatë studimeve katërvjeçare. "Si ministër i Mbrojtjes besoj se me suksesin më të lartë do të real-



të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së



izoni planin mësimor dhe praktik të paraparë dhe me njohuritë e arritura në të ardhmen do të bëheni oficerë të NATO- së, krah për krah me kolegët tuaj nga ushtritë e vendeve anëtare të Aleancës, do të jepni kontributin tuaj në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit kudo që është e nevojshme", theksoi në fund të letër-urimit të tij, ministri Quni. Ceremonia përkatëse u organizua me fillimin e vitit akademik 2020/21 të QSU-së për Gjeneratën-24 të saj me 16 kadetët-studentë, të cilët do të ndjekin studimet e rregullta katërvjeçare sipas plan-programeve mësimore me module teorike dhe praktike me standarde të akademive më të avancuara ushtarake perëndimore, e veçanërisht të SHBA-së.

Gjermania i dhuron pajisje mjekësore FSK-së

Prishtinë, 11 shtator 2020. Në kazermën „Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, sot u mbajt ceremonia e pranim-dorëzimit të donacionit në pajisje mjekësore nga Republika e Gjermanisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni, paraprakisht priti në zyrën e tij, ambasadorin e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, Joern Rohde. Në fillim ministri Quni e uroi ambasadorin Rohde për detyrën e re dhe mirënjohjen e thellë për mbështetjen e përhershme të Gjermanisë ndaj Kosovës. Ai theksoi, se edhe donacioni që pranojmë sot është në vazhdën e ndihmës së madhe të Gjermanisë, Ministrisë së saj të Mbrojtjes dhe forcave gjermane për ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin në stadin aktual të ministrisë dhe forcave tona. Ministri Quni vlerësoi lart edhe angazhimin e oficerëve dhe nënoficerëve gjerman në kuadër të ekipit të NALT nën lidershipin e gjeneralit Best, i cili vazhdon traditën e paraardhësve tjerë me profesionalizëm dhe efektivitet të lartë. "Gjermania si vend mik yni, është njëri ndër partnerët tanë kryesor strategjik dhe se sukseset tona të deritashme, bashkë me partnerët tjerë, janë të arritura të përbashkëta". Nga ana e tij, ambasadori Rohde, ritheksoi zotimin e Gjermanisë për vazhdimin e mbështetjes së FSK-së për të arritur objektivat e saj zhvillimorë dhe shprehu konfirmimin për intensifikimin dhe thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit dypalësh. Gjatë takimit ministri Quni shoqërohej nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe drejtori i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integrime Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha. Pas takimit, ministri Quni dhe ambasadori Rohde, morën pjesë në ceremoninë e pranim- dorëzimit donacionit me vlerë prej 500 mijë € në Regjimentin e Mjekësisë, respektivisht Qendrën Mjekësore të FSK-së. Nga ana e tij, gjeneral Rama e falënderoi ambasadorin Rohde dhe stafin ushtarak gjerman për angazhimin e tyre të madh për këtë donacion dhe të gjitha donacionet dhe kontributet e tyre të deritashme për ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së. Ambasadori Rohde gjatë ceremonisë para të pranishmëve tha: "Është kënaqësi e veçantë që sot, gjatë vizitës time të parë në Ministrinë e Mbrojtjes, në emër të Qeverisë Gjermane, kam rastin të dorëzoj një donacion të madh me pajisje mjekësore. Ky donacion do t'i mundësojë Shërbimit Mjekësor të FSK-së për të ngritur gatishmërinë e FSK-së në mënyrë që ajo të arrijë të ashtuquajturin, kapacitet të „Rolit 1" të NATO-s. Realizimi i këtij donacioni ka qenë një bashkëpunim gjermano-kosovar në mes të këshilltarëve gjermanë dhe ekspertëve mjekësorë të FSK-së.". Në fund, ministri Quni shprehu rëndësinë që kanë këto pajisje për aftësimin e personelit tonë për të qenë të gatshëm gjithmonë për reagim dhe trajtim të ndërsjellë në operacione dhe shpëtimit të jetëve të qytetarëve. "Për çdo jetë të shpëtuar do të jemi krenar së bashku", theksoi në fund ministri Quni. Të pranishëm në ceremoni ishin edhe zyrtarë dhe oficerë nga ambasada dhe forcat gjermane si dhe nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë e Kosovës. Donacioni i sotëm është në vazhdën e mbështetjes së qeverisë dhe forcave gjermane në kompletimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të Regjimentit të Mjekësisë së FSK-së dhe shërbimit mjekësor të saj në të gjitha nivelet.





Caritas Kosova i dhuron shtretër spitalorë FSK-së



Prishtinë, 22 shtator 2020. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni priti sot në takim delegacionin e Caritas Kosova, të kryesuar nga drejtori gjeneral Don Viktor Sopi, me rastin e dhurimit të shtretërve modern mjekësor për nevojat e Qendrës Mjekësore të FSK-së. Me këtë rast, ministri Quni falënderoi Don Viktor Sopin për këtë donacion të rëndësishëm. Ai gjithashtu, çmoi lart misionin dhe veprimtarinë e jashtëzakonshme humanitare gati 30- vjeçare të Caritas Kosova, me ndihmat e mëdha në përgjigje sistematike ndaj varfërisë, sfidave, dhimbjeve dhe nevojave me të cilat përballen shtresat më të rrezikuara dhe margjinalizuara të shoqërisë sonë. Ai, shprehu mirënjohjen e lart edhe për përkushtimin e madh të Caritas Kosova gjatë dhe pas luftës në sigurimin e ndihmave emergjente, rehabilitimin e qëndrueshëm, ndihmat sociale dhe ndihmat shëndetësore për qytetarët e vendit në nevojë. Nga ana e tij, Don Viktor Sopi falënderoi për mikpritjen dhe rikujtoi bashkëpunimin e ngushtë me FSK-në në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, duke shprehur interesimin për thellim të mëtejmë të këtij bashkëpunimi dhe shtimin e aktiviteteve të përbashkëta në të mirën e qytetarëve tanë në nevojë. Gjatë takimit, ministri Quni shoqërohej edhe nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe shefi i kabinetit të tij, Jashar Ramadani.



Donacione për FSK-në nga Republika e Turqisë





Prishtinë, 04 shtator 2020. Në kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së në Prishtinë, sot u bë pranim-dorëzimi i kontingjentit të dytë të donacionit me veshmbathje ushtarake nga Republika e Turqisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës në vlerë financiare prej rreth një milion dollar. Ceremonia e pranim- dorëzimit të pajisjeve përkatëse u bë në prani të zyrtarëve dhe oficerëve të logjistikës të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së dhe Komandës së Logjistikës si dhe atasheut ushtarak turk në Kosovë me stafin e tij. Në emër të qeverisë turke, donacionin e dorëzoi, atasheu i Republikës së Turqisë, kolonel Ismail Cenkeri Ersoz, kurse ,në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, e pranoi, oficeri i Departamentit të Logjistikës së SHPFSK-së, major Nazmi Zogaj, i cili falënderoi kolonel Ersoz për donacionin e dhuruar dhe mbështetjen e vazhdueshme të ushtrisë dhe shtetit turk për FSK-në.

Në Drelaj të Pejës FSK-ja evakuon 4 qytetarë



Prishtinë, 21 shtator 2020. Njësia e Kërkim -Shpëtimit e Gardës Kombëtare të FSK-së ka realizuar me sukses operacionin e kërkim-shpëtimit malor në fshatin Drelaj të Rugovës së Pejës. Operacioni, në kushte nate dhe terren të vështirë, u zhvillua, duke filluar në orën 23 dhe duke përfunduar me sukses në orët e hershme të mëngjesit, me kërkimin, shpëtimin dhe evakuimin e katër personave. Personat e shpëtuar ishin pjesëtarë të Shoqatës Alpiniste "Gjeravica", njëri prej të cilëve ishte i lënduar dhe iu ofrua trajtim fushor mjekësor dhe evakuim profesional. Njësia e FSK-së, operacionin e realizoi në koordinim me njësitë e Policisë së Kosovës, Zjarrfikësit lokalë, ndërsa evakuimin e personave e ka bërë në bashkëpunim me Shoqatën e Kërkim -Shpëtimit Malor "Peja". Angazhimi vetëmohues dhe profesionalizimi i lartë i pjesëtarëve të Njësisë së Kërkim- Shpëtimit të FSK-së, si edhe njësive tjera, dëshmohen në çdo kohë, në çdo vend dhe në çdo situatë në shërbim të qytetarëve tanë.



Pjesëtarët e FSK-së shpëtuan qytetarët e aksidentuar në Zahaq të Pejës





Prishtinë, 02 shtator 2020. Dy pjesëtarë të Regjimentit të Dytë të Forcave Tokësore të FSK-së, nënoficerët Visar Qakolli dhe Dylber Vrenezi, deri sa po ktheheshin në shtëpi nga shërbimi i tyre, kanë hasur në një aksident komunikacioni në fshatin Zahaq të Pejës. Një autocisternë ishte rrokullisur dhe brenda saj të ngujuar kishin mbetur dy persona të lënduar. Sipas procedurave standarde të reagimit, pjesëtarët e FSK-së, pasi kanë njoftuar Policinë e Kosovës për aksidentin, kanë filluar intervenimin nën kushte të rrezikut shumë të lartë.

Ata kanë nxjerrë personat e lënduar nga automjeti deri sa ishte duke rrjedhur nafta nga cisterna. Pas evakuimit, të lënduarve u është dhënë ndihma e parë (ndalja e gjakderdhjes dhe fashimi i plagëve). Njëkohësisht kanë menaxhuar me trafikun në vend-aksident duke ndaluar automjetet e tjera të afrohen në zonën e rrezikut deri në ardhjen e policisë dhe autoambulancës. Si gjithmonë, edhe në këtë rast, veprimi i pjesëtarëve të FSK-së dëshmon përkushtimin dhe vendosmërinë e natyrshme në shërbim të qytetarëve dhe vendit deri në vetëmohim.















FORCA JONË


*** Viti VIII • Nr. 93 • 1 Dhjetor 2020 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni mori pjesë në Konferencën Karta e Adriatikut, A5-SHBA



Prishtinë, 30 Nëntor 2020. Me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes së Bosnjës e Hercegovinës, Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni sot mori pjesë në konferencën e Kartës së Adriatikut, A5-SHBA, në nivel të ministrave të mbrojtjes. Për shkak të rrethanave të krijuara nga kriza e pandemisë COVID-19, takimi u realizua përmes video-konferencës me pjesëmarrje edhe të ministrave të mbrojtjes nga Bosnja e Hercegovina, Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, dhe Mali i Zi si anëtare të rregullta, përfaqësuesi nga Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-së dhe Republika e Kosovës si vend me status të anëtarit vëzhgues. Konferenca u zhvillua në dy sesione plenare me temat të cilat u fokusuan në programet e bashkëpunimit rajonal të mbrojtjes, me theks të veçantë në pandeminë aktuale COVID-19, ndikimit të saj në performancën e aktiviteteve të planifikuara të institucioneve të mbrojtjes, si dhe epoka post-COVID me rreziqet, sfidat dhe mundësitë. Gjithashtu, në sesion të veçantë u shqyrtua rëndësia e partneritetit të NATO-s dhe integrimit euro-atlantik në menaxhimin e krizave dhe përballjen e sfidave aktuale të sigurisë. Në ekspozenë e tij, ministri Quni ofroi informacionet kryesore për ndikimin e pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe masat reaguese anti-covid të qeverisë së vendit me institucionet ekzekutive të saj. Ai theksoi rolin dhe misionin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së me aftësitë dhe kapacitetet e saj operacionale në mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile dhe qytetarëve të vendit në përgjithësi në efektivitetin dhe efikasitetin e masave anti-covid. Gjithashtu, ministri Quni, i njoftoi homologët e tij edhe me sfidat që ka shkaktuar pandemia COVID-19 në funksionalitetin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe operacionalitetin e përgjithshëm të FSK-së, pastaj procesin e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara paraprakisht për periudhën përkatëse, mësimet e nxjerra nga kjo krizë dhe vizionin për të ardhmen. Lidhur me rëndësinë e partneritetit të NATO-s dhe integrimeve euroatlantike, ai theksoi se, Karta e Adriatikut –SHBA, është iniciativa që përputhet plotësisht me aspiratat tona në procesin e integrimeve euro-atlantike dhe me vullnetin tonë për të qenë anëtare e plotë e saj. ”Ne dëshirojmë të jemi ofrues të sigurisë dhe jo vetëm konsumues të saj. Duam të japim kontributin tonë në të gjitha çështjet që janë brengë e rajonit. Kemi vullnetin ta bëjmë këtë, dhe po ndërtojmë kapacitetet e duhura në këtë drejtim” tha në fund ministri Quni. Sipas agjendës, në fund të punimeve, ministrat e Mbrojtjes miratuan Deklaratën e Përbashkët me konkluzionet e konferencës.

Konferenca „FSK dhe partnerët 2020“, dëshmi e suksesit të garantuar të FSK-së në misionin e saj



Prishtinë, 21 tetor 2020. Nën organizimin e Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrime Euroatlantike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, nën masat kufizuese kundër covid, u mbajt sesioni kryesor i Konferencës „FSK dhe partnerët 2020“.


(Faqe 4)

Komandanti i FSK-së vizitë zyrtare në Shtabin Suprem të Forcave Aleate të Evropës



Prishtinë, 24 Nëntor 2020. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama qëndroi në vizitë zyrtare në Shtabin Suprem të Forcave Aleate të Evropës (SHAPE) në Mons të Belgjikës ku u takua me komandantin Suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë (SACEUR), gjeneralin Tod Wolters. Fillimisht, gjeneral Rama falënderoi gjeneralin Wolters për angazhimin e trupave të NATO-së në kuadër të misionit të KFOR-it në funksion të sigurisë së përgjithshme në Kosovë si dhe mbështetjes së vazhdueshme në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit tonë. Gjithashtu, gjeneral Rama shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për kontributin dhe angazhimin e Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së në të gjitha aspektet. Ai e njoftoi gjeneralin Wolters për të arriturat e gjithmbarshme të FSK-së, procesin e tranzicionit, si dhe shkallën e ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse të FSK-së. Ndër të tjera, gjeneral Rama, ritheksoi se të gjitha aftësitë dhe kapacitetet operacionale të FSK-së zhvillohen sipas standardeve te NATO-s në mënyrë që të jenë të ndërveprueshme me forcat e vendeve anëtare të NATO-s. Ndërlidhur me këtë fakt, gjeneral Rama i shprehu gjeneralit Wolters, gatishmërinë për ofrimin e kapaciteteve të FSK-së për pjesëmarrje në operacionet paqeruajtëse të Aleancës për të dhënë kontributin e saj në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë së përgjithshme. Nga ana e tij, gjenerali Wolters përgëzoi gjeneral Ramën si dhe shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për të arriturat e deritashme të FSK-së si dhe kontributin e saj në sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e përgjithshëm në vend dhe rajon. Ndër të tjera ai ritheksoi përkushtimin e NATO-s për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë dhe rajon. Të dy gjeneralët diskutuan për vazhdimin e bashkëpunimit të mëtejmë të NATO-s përmes kapaciteteve të KFOR-it dhe mekanizmave tjerë të NATO-s me FSK-në përmes shkëmbimit të përvojave në funksion të ngritjes së kapaciteteve dhe profesionalizimit të FSK-së.

Me ceremoni ushtarake shënohet 27 Nëntori - Dita e Forcës



Prishtinë, 27 Nëntor 2020. Në kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së, në Prishtinë, sot me ceremoni ushtarake u shënua 27 Nëntori - Dita e Forcës.

(Faqe 5)

FSK-ja pjesë e ushtrimit ndërkombëtar „KFOR 28”



Gjermani, 04 Nëntor 2020. Një kontingjent i Forcës së Sigurisë të Kosovës nga Kompania e Materieve të Rrezikshme (MKAB) e Gardës Kombëtare po merr pjesë në ushtrimin fushor ndërkombëtar „KFOR 28”në bazën ushtarake amerikane Hohenfels të Republikës Federale të Gjermanisë. Ushtrimi fushor „KFOR 28” trajnon dhe përgatit trupat për mision në Kosovë. Ky ushtrim është vlerësues për trupat para zbarkimit për mision, përkatësisht me fokus kryesor situatën aktuale në territorin e Kosovës. „KFOR 28” ofron informacione paraprake dhe të mjaftueshme lidhur me mjedisin operacional, situatën sociale, politike, ushtarake dhe ekonomike në vend. Përveç aspektit të planifikimit trajnon të gjithë personelin në aspektin fizik, mental dhe taktik. Qëllim i këtij ushtrimi është ngritja e profesionalizmit të njësisë së MKAB-së, përgatitja e tyre për të vepruar dhe punuar në mjedis të kombinuar shumëkombësh si dhe shkëmbimi i përvojave.


Përmbyllje e suksesshme e stërvitjes fushore „Ujku vigjilent-02“



Prishtinë, 25 Nëntor 2020. Në Poligonin e stërvitjeve taktike në fshatin Cernushë, u realizua Stërvitja Fushore katër ditore „Ujku vigjilent-02“.

(Faqe 8)

Forca e Sigurisë së Kosovës edhe në vitin 2020 institucioni më i besueshëm në vend



Prishtinë, 26 Nëntor 2020. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar edicionin e dhjetë të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) përmes të cilit maten perceptimet publike në Kosovë në lidhje me besimin e qytetarëve në institucione dhe çështje të ndryshme që lidhen me sigurinë. Nga të gjitha të dhënat rezulton se, Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdon të jetë institucioni më i besuar, me 81 për qind të të anketuarve që kanë besim ose besim të plotë në të. Në edicionin e tij të dhjetë, BKS-ja ka marrë një shtrirje rajonale dhe është zhvilluar paralelisht në Kosovë dhe Serbi duke shënuar edicionin e parë të Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). Edicioni i BKS, raporti për Kosovën, përbëhet nga tre kapituj. Kapitulli i parë paraqet perceptimet e qytetarëve lidhur me besueshmërinë në institucionet e sigurisë, drejtësisë, si dhe në institucione e nivelit qendror dhe lokal. Në anën tjetër, kapitulli i dytë interpreton perceptimet e qytetarëve lidhur me korrupsionin në këto institucione. Së fundmi, në kapitullin e tretë reflektojnë të gjeturat e raportit për kontaktin e drejtpërdrejtë të qytetarëve me këto institucione në 12 muaj e fundit. Teksa në kapitujt e lartpërmendur ky raport ofron një pasqyrë të përgjithshme të perceptimeve të qytetarëve, ai gjithashtu paraqet zbërthimin e të dhënave sipas gjinisë, rajonit, zonës (urbane/rurale), moshës (18-35/36+) dhe përkatësisë etnike të të anketuarve. Për më tepër, raporti ofron analiza shtesë për arsyet pse ekzistojnë perceptime të tilla të qytetarëve në lidhje me çështjet e paraqitura Ky raport është publikuar në kuadër të projektit rajonal "Barometri i sigurisë në Ballkanin Perëndimor - promovimi i llogaridhënies në Institucionet e Sigurisë dhe Drejtësisë" i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED). Forca e Sigurisë së Kosovës, epitetin e institucionit më të besueshëm në vend, vazhdon ta mbajë për vite me radhë. Ky është rezultat i politikave të duhura të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional me transparencë dhe llogaridhënie të plotë në të gjitha nivelet e udhëheqjes, administrimit dhe funksionimit të Ministrisë së Mbrojtjes si dhe drejtimit, komandimit dhe operacionalitetit të FSK-së.

FSK-ja forcë shumetnike në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit



Istog, 7 tetor 2020. Në Komandën e Forcave Tokësore në Istog, ishte për vizitë zëvendësministrja e Mbrojtjes z. Sadika Kofrc. Ajo u prit nga stafi udhëheqës i KFT-së, i kryesuar nga komandanti i saj, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, i cili e njoftoi me zhvillimet e përgjithshme aktuale të komandës dhe njësive vartëse të saj si dhe të arriturat e gjithmbarshme. Prezantimi përkatës u pasua me demonstrimin praktik të shkathtësive taktike nga njësitet e Regjimentit të Dytë të Këmbësorisë. Me pas, zëvendësministrja Kofrc dhe delegacioni që e shoqëronte u takua me pjesëtarët e FSK-së nga radhët e komuniteteve joshumicë të njësisë përkatëse. Nga ta, ajo, u njoftua me përshtypjet e tyre për sistemin organizativ dhe funksional të njësisë, preokupimet e tyre si dhe çështje të tjera me interes. Zëvendësministrja Kofrc çmoi lart stafin komandues të KFT-së dhe angazhimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në të gjitha aktivitetet. Ajo, në emër të ministrit Quni, shprehu zotimin se politikat ministrore janë dhe do të jenë në funksion të respektimit të plotë të të drejtave të pjesëtarëve nga radhët e të gjitha komuniteteve, duke konfirmuar çdo herë se FSK-ja është e të gjithëve dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallime etnike, racore e fetare. Gjatë vizitës, zëvendësministrja Kofrc shoqërohej nga shefja e Zyrës për Komunitete të Ministrisë së Mbrojtjes znj. Lejla Loci, këshilltari ushtarak i ministrit kolonel Hamdi Pollomi, zyrtarja e lartë e Kabinetit të Ministrit znj.Martina Dedaj-Kqira dhe major Fadil Vojvoda.

Komisionet parlamentare për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes si dhe për Buxhet e Transfere vizituan SHP të FSK-së



Prishtinë, 04 Nëntor 2020. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama me stafin e tij, pritën sot në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, respektivisht anëtarët e komisioneve parlamentare, atij për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes si dhe të komisionit për Buxhet e Transfere. Në fillim, gjeneral Rama, shprehu falënderimin për vizitën si dhe njoftoi deputetët lidhur me zhvillimet e përgjithshme aktuale të FSK-së, sfidat aktuale si dhe objektivat zhvillimor për të ardhmen. Në vazhdim, përmes prezantimeve, oficerët e SHP të FSK-së njoftuan të pranishmit me aspektin e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit, procesin planifikues të vitit pasues, afatmesëm dhe atij afatgjatë të ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve të plota operacionale të FSK-së si dhe kuadrit buxhetor të nevojshëm për realizimin e planeve përkatëse. Ndër të tjera, gjeneral Rama theksoi se përkundër krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19 dhe fokusit për luftimin e saj, FSK ka arritur me sukses të realizoj pjesën më të madhe të aktiviteteve të planifikuara, në funksion të përmbushjes së objektivave të ministrit të mbrojtjes. "Meqë jemi në vitin e dytë të procesit të tranzicionit të FSK-së në misionin e forcës ushtarake, edhe objektivat tanë janë me fokus në përmbushjen e aktiviteteve në përputhje me Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, respektivisht në drejtim të arritjes së aftësive dhe kapaciteteve të plota operacionale deri në vitin 2028, kapacitete këto të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor" tha ai. Në fund, gjeneral Rama kërkoi nga anëtarët e dy komisioneve, mbështetjen nga ana e tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konkretisht në miratimin e kërkesave buxhetore të FSK-së të planifikuara për vitin 2021. Pas ekspozesë së gjeneral Ramës, anëtarët e komisioneve përkatëse të kryesuara nga Fatmire Kollçaku–Mulhaxha dhe Hekuran Murati, duke vlerësuar lart të arriturat e deritashme të FSK-së me diskutimet dhe pyetjet e tyre shprehën interesimin lidhur me statusin e projekteve kapitale të blerjes dhe atyre infrastrukturore të FSK-së, gjendjen e pjesëtarëve në rrethanat e pandemisë COVID-19, procesin e integrimit të pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë dhe sfidat në këtë proces. Ata u zotuan se, përkundër vështirësive buxhetore që ka shkaktuar dhe pritet të shkaktoj kriza e pandemisë, nga autoriteti i tyre do të mbështesin kërkesat buxhetore të FSK-së për realizimin e projekteve të planifikuara. Për organizimin si dhe të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e komisioneve përkatëse, me përgjigjet dhe angazhimin profesional kontribuuan edhe stafi shoqërues i gjeneral Ramës në përbërje prej gjeneralmajor Enver Cikaqit, gjeneral brigade Jeton Dreshajt, kolonel Agron Bajramit, kolonel Ejup Maqedoncit, nënkolonel Berat Shalës, major Korab Dautit, kapitene Manushaqe Nurës dhe këshilltares ligjore nga SHBA, Katherine Barton. FSK përmes takimeve të ngjashme, por edhe takimeve raportuese vazhdon të përmbushë në mënyrë të plotë obligimin ligjor në funksion të transparencës dhe llogaridhënies së plotë para përfaqësueseve të Kuvendit të Republikës së Kosovës si organi kushtetues i ushtrimit të kontrollit demokratik parlamentar.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni priti ambasadorin e Hungarisë z.József Bencze



Prishtinë, 20 Nëntor 2020. Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, priti sot ambasadorin e Republikës së Hungarisë në vendin tonë, József Bencze në vizitën e tij të parë në Ministrin e Mbrojtjes. Në fillim, ambasadori Bencze vlerësoi lart rëndësinë e partneritetit në mes dy ministrive duke shprehur gatishmërinë e shtetit hungarez dhe institucioneve të saj në mbështetjen e mëtejme të FSK-së për arritjen e objektivave të saj. Ministri Quni, nga ana e tij falënderoi për vizitën dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen e deritashme të Hungarisë në të gjitha fushat, përmes kontributit me kontingjentin ushtarak në kuadër të KFOR-it, në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të Ministrisë së Mbrojtje dhe FSK-së. Ai gjithashtu kërkoi ofrimin e eksperiencës për procesin reformues të FSK-së si dhe eksperiencën e zbatuar të institucioneve hungareze për procesin integrues euroatlantik në NATO. Ministri Quni, në vazhdim theksoi se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, janë në proces të realizimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, proces i cili zhvillohet në transparencë të plotë, dhe si gjithmonë, në koordinim të plotë me partnerët tanë. Në fund të dy bashkëbiseduesit u pajtuan për vazhdimin e bashkëpunimit në funksion të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë. Në takimin përkatës, Ministri Quni shoqërohej nga këshilltari i tij poltik, Feriz Trezhnjeva, kurse ambasadori Bencze shoqërohej nga sekretari i dytë i ambasadës hungareze, Zoltan Gulyas. Marrëveshja dypalëshe e bashkëpunimit në mes Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës (ish-Ministrisë së FSK-së) dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë, është nënshkruar më 10 qershor 2016 në Budapest. Marrëveshja përcakton bashkëpunimin në fushën e arsimimit dhe stërvitjes, shkëmbimit të përvojave në menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e krizave, rrugën e integrimeve euroatlantike etj.

Rekrutët e rinj testohen sipas standardeve të ushtrive bashkëkohore



Prishtinë, 15 tetor 2020. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni i shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Rrahman Rama dhe atasheu i Mbrojtjes së SHBA-së, kolonel Stephen Rose, realizuan një vizitë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj. Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër me procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për ushtarë aktivë të FSK-së gjatë testimit fizikë , i cili është duke u realizuar në kuadër të procesit rekrutues për vitin 2020. Paraprakisht, ministri Quni, me delegacionin e i tij, vizitoi Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ku nga ana e shefit të Departamentit të Personelit, kolonel Ilir Shyti, u njoftua me procesin e përgjithshëm të rekrutimit, aktivitetet, të arriturat dhe procedurat e deritashme të përzgjedhjes në këtë proces. Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, ministri Quni dhe gjeneral Rama u pritën nga komandantit i kësaj doktrine gjeneral brigade Irfete Spahiu, e cila i njoftoi, ata, me aktivitetet e njësisë në përgjithësi, me fokus angazhimin e pjesëtarëve të saj në mbështetjen e përgjithshme të ekipit vlerësues për realizimin sa më me sukses të testimit fizik të kandidatëve për ushtarë aktivë. Në fjalën e tij, ministri Quni vlerësoi lart angazhimin e Departamentit të Personelit të SHPFSK-së, të Ekipit Vlerësues të Instruktorëve dhe të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, për angazhimin e tyre dhe të arriturat e deritashme edhe pse në kushte të kufizuara të masave kundërcovid. Ai shprehu besimin e tij se gjatë këtij procesi do të vlerësohen kandidatët më të suksesshëm për garim në fazat e tjera, duke e kurorëzuar këtë proces me përzgjedhjen e kontingjentit të synuar të ushtarëve të rinj për vitin 2020. Nga ana e tij, gjeneral Rama, shprehu mirënjohjen për angazhimin e deritashëm dhe kërkoi nga përgjegjësit që të vazhdojnë me respektimin e plotë të procedurave dhe kritereve të standardeve më të larta të testimit, në pajtueshmëri me ato të vendeve të avancuara të NATO-s. Përshtypjet e tij gjatë vizitës i shprehu edhe kolonel Rose, i cili çmoi lart përkushtimin e të gjithëve për realizimin sa më të suksesshëm të testimit edhe pse nën masat kufizuese kundër-covid. Në vazhdim, ministri Quni dhe gjeneral Rama, me delegacionin shoqërues, vizituan stacionet e testimit fizik, ku panë nga afër ekzekutimin e disiplinave nga ana e kandidatëve të sotëm si dhe procedimin e vlerësimit të tyre nga ana e personelit të autorizuar. "Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja iu shërbejnë të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe ju mirëpresin juve për shërbim në FSK, pa dallim nga përkatësia e juaj etnike",- shprehet, ndër të tjera, ministri Quni para kandidatëve të pranishëm. Kurse gjeneral Rama kandidatët e pranishëm i inkurajoi për rezultate sa më të larta në testime, duke ua rikujtuar nderin, privilegjin dhe përgjegjësinë e lartë e të qenët ushtarë në mbrojtje të vendit e të qytetarëve. Procesi i rekrutimit të ushtarëve në FSK për vitin 2020 ka filluar më 10 gusht, me fazën e aplikimit, duke vazhduar me shqyrtimin fillestar të aplikacioneve. Nga data 28 shtator është duke u zhvilluar procesi i testimit fizik për të vazhduar me testet dhe procedurat tjera. Ky proces është duke u monitoruar edhe nga ekipi i Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) që dëshmon transparencën dhe llogaridhënien e plotë institucionale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së si institucione me besueshmërinë më të lartë qytetare për vite me radhë.



Në Ministri të Mbrojtjes mbahet Konferenca „FSK dhe partnerët 2020“



Prishtinë, 21 tetor 2020. Nën organizimin e Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrime Euroatlantike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, nën masat kufizuese kundër covid, u mbajt sesioni kryesor i Konferencës „FSK dhe partnerët 2020“, ku morën pjesë atashe të mbrojtjes rezidentë dhe jorezidentë të akreditуar në Kosovë nga vendet partnere si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Shqipëria, Kroacia, Italia, Turqia, Franca, Holanda, Japonia, Çekia, Hungaria, Maqedonia. Po ashtu të lidhur me video në konferencë ishin edhe atashetë e mbrojtjes nga Sllovenia dhe Mali i Zi. Në konferencë morën pjesë: ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, zëvendësministrja e Mbrojtjes, Sadika Kofrc, zëvendësministri i Mbrojtjes, Muhametalli Mergjollar, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Faruk Geci, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, drejtori i Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjeneral brigade Frank Best, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Gunter Schopf, atashetë e mbrojtjes së Kosovës si dhe oficerë dhe zyrtarë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, FSK-së, KFOR-it dhe NALT-it. Konferencën e shpalli të hapur, ministri i Mbrojtjes Anton Quni, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e veçantë të konferencës duke pasur parasysh periudhën intensive të aktiviteteve përmbyllëse të vitit të dytë të tranzicionit dhe objektivat e tij për vitin pasues. Duke vlerësuar rëndësinë e madhe të konferencës tashmë tradicionale, ministri Quni nënvizoi se „konferenca e sotme është momenti i duhur për të vlerësuar të arriturat tona të deritashme dhe për të përcaktuar projektet tona të përbashkëta për të ardhmen e FSK-së“. Ai më pas theksoi se këto të arritura i atribuohen mbështetjes së madhe të partnerëve tanë dhe bashkëpunimit të fuqishëm me ta.“ Gjithçka që kemi arritur deri më tani është fal mbështetjes suaj dhe për këtë u jemi mirënjohës përgjithmonë. Sfidat e sigurisë, respektivisht kërcënimet dhe rreziqet aktuale vazhdojnë të mbeten sfida të përbashkëta andaj edhe kërkojnë reagimin tonë të përbashkët. Këtë e dëshmoi edhe kriza aktuale globale që shkaktoi pandemia COVID-19, e cila domosdoshmërish shfaqi nevojën për reagimin tonë të përbashkët“, - tha ai. Ministri Quni, gjithashtu theksoi se bashkëpunimi dypalësh me ministritë dhe forcat e vendeve partnere, NALT-in, KFOR-in dhe partneriteti i ngushtë me Gardën Kombëtare të Iowa-s, janë dëshmuar në të gjitha dimensionet, tregime të sukseseve të mëdha me perspektivë të qartë zhvillimore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-në. „Politikat tona të mbrojtjes mbështeten fuqishëm mbi parimet, vlerat dhe standardet më të larta të NATO-s. Kjo nënkupton vullnetin dhe gatishmërinë tonë për ofrimin e kontributin tonë në partneritet të ngushtë me ju për pjesëmarrje në operacione të përbashkëta shumëkombëshe humanitare dhe paqeruajtëse“,- tha në fund ministri Quni. Nga ana tjetër, gjeneral Rama, në fjalën e tij, shprehu mirënjohjen e thellë për mbështetjen e madhe të vendeve partnere për të arriturat e deritashme në të gjitha fushat dhe nivelet e zhvillimit dhe funksionimit të FSK-së. FSK-ja ka nderin të jetë institucioni më i besuar në Kosovë për shumë vite me radhë. Merita e kësaj arritjeje ju përket juve. Falë mbështetjes suaj, FSK-ja sot është më e përgatitur për të mbështetur autoritetet civile dhe për të ndihmuar qytetarët e Kosovës, si dhe e gatshme për të dhënë kontributin e saj në shërbim të paqes dhe sigurisë në rajon dhe më gjerë“, - shprehet ai. Gjeneral Rama e vlerësoi si jetike mbështetjen e FSK-së nga partnerët, si me përvojat e tyre ashtu edhe me bashkërendimin e aktiviteteve në përmbushjen me sukses të objektivave të përbashkët. „Vetëm duke punuar së bashku ne mund të fuqizojmë dhe promovojmë paqen dhe stabilitetin në rajon dhe botë,“- tha në fund gjeneral Rama. Konferencën e përshëndetën edhe gjeneral Best në emër të NALT-it dhe gjeneral Schopf në emër të komandës së KFOR-it. Të dy, vlerësuan lart të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së si dhe bashkëpunimin e ngushtë dhe të suksesshëm në përmbushjen e detyrave dhe aktiviteteve të përbashkëta. Zotimet për fuqizimin e partneritetit edhe në të ardhmen i prezantuan në fjalimet e tyre edhe atashetë pjesëmarrës nga vendet partnere. Në vazhdim të punimeve të konferencës, sipas agjendës së përcaktuar, oficerët e FSK-së: kolonel Ejup Maqedonci, kolonel Haki Hoti, kolonel Agron Bajrami dhe major Dedë Hyseni prezantuan: bashkëpunimin ndërkombëtar, procesin e tranzicionit të FSK-së, planin zhvillimor të FSK-së 2021-2023, procesin e menaxhimit të krizës së pandemisë COVID-19 si dhe gamën e operacioneve, shkollimeve, trajnimeve dhe stërvitjeve të FSK-së. Në sesionin e nesërm, për të finalizuar punimet e konferencës, në takime të ndara do të realizohen takimet dypalëshe veç e veç mes delegacioneve të FSK-se dhe delegacioneve të vendeve partnere për të analizuar dhe vlerësuar fushat në të cilat nevojitet mbështetja e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale për periudhën 3-vjeçare me finalizimin e planeve dypalëshe për vitin 2021 dhe draftimin e koncept-planit për periudhën pasuese.

FSK-ja shënoi 27 Nëntorin - Ditën e Forcës







Prishtinë, 27 Nëntor 2020. Në kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së, në Prishtinë, sot me ceremoni ushtarake u shënua 27 Nëntori - Dita e Forcës. Për shkak të masave anti-covid, këtë vit aktivitetet ceremoniale u realizuan me pjesëmarrje të kufizuar. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë: Ushtruesja e detyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani - Sadriu, kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, zëvendëskryeministri Driton Selmanaj, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Frank Best, ministra, zëvendësministra, deputetë, familjarë të dëshmorëve të kombit, atashe e oficerë ushtarakë të vendeve partnere si dhe oficerë, nënoficerë e ushtarë të FSK-së. Ceremonia zyrtare filloi me intonimin e himnit të Republikës së Kosovës dhe me performancën ushtarake në nderim të të rënëve për liri nga ana e Togut Ceremonial dhe Bendit Muzikor të FSK-së. U.d. Presidentja Osmani, në fjalën e saj, drejtuar përfaqësueseve të institucioneve të vendit, si dhe oficerëve e nënoficerëve të FSK-së, theksoi rëndësinë e madhe që ka kjo ditë jo vetëm për Ushtrinë e Kosovës, por për të gjithë popullin e saj dhe historinë e saj të lavdishme. Ajo ndërlidhi simbolikën e themelimit të saj mbi luftën dhe sakrificën e madhe të komandantit Adem Jashari dhe Familjes Jashari si dhe politikën largpamëse për krijimin e miqësisë me aleatët perëndimor të kryesuar nga SHBA, të Presidentit historik, Ibrahim Rugova. Ajo theksoi vizionin për Kosovën që duam si një vend të sigurt, të zhvilluar ekonomikisht, si dhe të integruar në NATO dhe Bashkimin Evropian. Ndërsa, kryeministri Hoti, në fjalën e tij, vlerësoi lartë kontributin e madh të FSK-së në të gjitha angazhimet institucionale e posaçërisht gjatë periudhës së përballjes me krizën e pandemisë COVID-19. Ai vlerësoi se angazhimi vetëmohues me përkushtim të plotë dhe profesionalizëm të lartë ka rezultuar me ruajtjen e epitetit për vite me radhë të institucionit me besueshmërinë më të lartë qytetare në vend. Ndër të tjera, ai shprehu zotimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që bashkë me autoritetet e FSK-së dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, të realizojnë planet zhvillimore për ushtri të strukturuar mirë, të disiplinuar dhe të përgjegjshme për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore të saj. Në fjalën e tij, ministri Quni, përveç të arriturave të deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, vlerësimit të angazhimit dhe përkushtimit të ushtarakëve të FSK-së, ai theksoi nivelin e lartë të bashkëpunimit dhe koordinimit me ministritë dhe forcat partnere, Ekipin Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) si dhe KFOR-in. Me këtë rast, ai shprehu mirënjohjen dhe falënderimin e madh për mbështetjen e shumanshme nga ana e tyre në zhvillimin dhe avancimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së në forca profesionale, moderne, me standardet më të larta të NATO-s dhe vendeve anëtare të saj të gatshme për ndërveprim në operacione të përbashkëta paqeruajtëse për të ofruar kontributin e çmueshëm për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë. Në fjalën e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, fillimisht ua uroi Ditën e Forcës të gjithë oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të saj, duke theksuar se suksesi i deritashëm i FSK-së qëndron mbi vlerat më të larta të besnikërisë, detyrës, respektit, shërbimit vetëmohues, nderit, integritetit dhe guximit personal të mishëruara në karakterin dhe personalitetit e çdo pjesëtari. Ndër të tjera ai nënvizoi rëndësinë e madhe që ka realizimi i Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit sipas dinamikës dhe përmbajtjes së paraparë duke potencuar nevojën e angazhimit të të gjithëve në këtë projekt madhor që ishte ëndërr e shumë brezave para nesh, kurorëzim dhe nderim i sakrificës së tyre si dhe kurorëzim i përpjekjeve të partnerëve tanë për ndërtimin e shtetit tonë dhe institucioneve të saj. Në fund të ceremonisë, para të pranishmëve u lexua vendimi i Ministrit Quni dhe urdhri i gjeneral Ramës, për ndarjen e mirënjohjeve dhe medaljeve me emrat e oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve si dhe zyrtarëve të dalluar të Ministrisë se Mbrojtjes dhe FSK-së. Ceremonia u mbyll nga Bendi Muzikor i FSK-së të cilët interpretuan pika të zgjedhura nga repertori i tyre.





Ministri Anton Quni dhe gjenerali Rrahman Rama homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz

Prishtinë, 28 Nëntor 2020. Me rastin e festës së 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit, Ditëlindjes së Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe Daljes publike të UÇK-së, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama me delegacionet e kryesuara të tyre, bënë nderime në kompleksin memorial para varrit të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe Familjes Jashari në Prekaz. Pjesë e



delegacioneve të tyre ishin: zëvendësministrja e Mbrojtjes Sadika Kofrc, zëvendësministri i Mbrojtjes, Mehmedali Mergjollari, sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, Rozafa Ukimeraj - Quni, drejtori i Drejtorisë për Politika të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes, Faruk Geci, drejtori i Drejtorisë për Inteligjencë dhe Siguri në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, dhe oficerë të tjerë të lartë ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së si dhe komandave e njësive kryesore të FSK-së. Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës janë institucione që ruajnë dhe kultivojnë në vazhdimësi, vlerat më të larta të trashëgimisë së saj dhe vlerave historike të vendit si frymëzim e motivim për realizimin me përgjegjësi të lartë të misionit të tyre në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit.

Emërohet Sekretare e Përgjithshme e Ministris së Mbrojtjes, znj. Rozafa Ukimeraj



Prishtinë, 26 Nëntor 2020. Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni priti sot, në ditën e parë të saj të punës, sekretaren e përgjithshme të sapoemëruar të Ministrisë së Mbrojtjes, Rozafa Ukimeraj. Duke i dëshiruar mirëseardhje, ministri Quni e siguroi sekretaren Ukimeraj se do të ketë të plotë bashkëpunimin dhe koordinimin në relacion me të si ministër dhe kabinetin e tij. Ai në vazhdim shprehu besimin e plotë në eksperiencën e lartë profesionale të znj. Ukimeraj në pozitën e ngjashme të dëshmuar me performancë të lartë edhe në dikasterin e mëparshëm. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, krahas urimeve për detyrën dhe fillimin e punës, shprehu besimin e plotë në vazhdimin e sukseseve të sistemit administrativ të ministrisë dhe koordinimin e plotë të të gjitha veprimeve dhe aktiviteteve me të si komandant dhe shtabin e përgjithshëm të FSK-së në funksion të përmbushjes së objektivave të ministrit. Ndërsa, zëvendës sekretari i Përgjithshëm, Faruk Geci, e siguroi sekretaren Ukimeraj se do të ofroj bashkëpunimin e plotë në periudhën njoftuese me stadin e zhvillimeve në sistemin administrativ të Ministrisë së Mbrojtjes si edhe në të ardhmen. Nga ana e saj, sekretarja Ukimeraj, falënderoi ministrin Quni për mirëpritjen dhe shprehu zotimin e saj për angazhim të plotë në vazhdimin e punëve të administratës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe intensifikimit të përkushtimit për suksese e të arritura edhe më të mëdha në vijim me parimin e pashmangshëm të punës ekipore. Ajo përgëzoi edhe gjeneral Ramën dhe zëvendës sekretarin Geci për të arriturat e deritashme dhe ofroi bashkëpunimin e plotë edhe në të ardhmen për të përmbushur obligimet kushtetuese dhe ligjore si dhe vizionin e ministrit, qeverisë dhe qytetarëve të vendit në përgjithësi.

Qeveria gjermane donacion për nevojat e FSK-së



Prishtinë, 16 Nëntor 2020. Në Ministrinë e Mbrojtjes, sekretari i Përgjithshëm, Faruk Geci, sot nënshkroi dy marrëveshje për dhurimin e fondeve të radhës nga Qeveria gjermane për nevojat e sistemit të mbështetjes operacionale të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) së FSK-së. Për shkak të masave kufizuese anti-covid nënshkrimi u bë në ambiente të ndara. Z. Geci nënshkroi në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës si palë pranuese, pas nënshkrimit të ambasadorit gjerman në Prishtinë, Joern Rohde, në emër të Ministrisë Federale të Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, nga pala dhuruese. Sipas programit gjerman „Mundësimi dhe rritja e sigurisë, mbrojtjes dhe stabilitetit të vendeve partnere“, pala gjermane dhuroi donacionin e radhës në vlerë prej 350,000 €, të cilat fonde sipas marrëveshjeve përkatëse do të përdoren ekskluzivisht për qëllime të prokurimit të pajisjeve për avancimin e sistemit të mbështetjes logjistike dhe operacionale të KDS-së. Me këtë rast në prani edhe të këshilltarit bilateral gjerman në Ministrinë e Mbrojtjes, nënkolonel Armin Dausch, sekretari Geci, në emër të ministrit të Mbrojtjes dhe komandantit të FSK-së shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e lartë për shtetin gjerman për donacionin e radhës si dhe mbështetjen e pandërprerë dhe shumë të rëndësishme në zhvillimin e përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Ministri Anton Quni vizitoi organizatën e deminimit, HALO Trust



Gjakovë, 27 tetor 2020. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni vizitoi Organizatën për Mbështetjen e Jetëve në Zonat e Rrezikshme (Hazardous Area Life-support Organization), të njohur si, HALO Trust – Programi në Kosovë. Me këtë rast, në selinë qendrore të saj, në Gjakovë, ministri Quni u prit prej menaxheres së HALO Trust–Programi në Kosovë, Olivia Meader e shoqëruar nga menaxheri i operacioneve, Maxime Robitaille dhe administratori, Agron Boshtraj. Pasi i dëshiroi mirëseardhje, znj. Meader e njoftoi ministrin Quni me misionin e organizatës, aftësitë dhe kapacitetet operacionale të angazhuara në programin për Kosovë që nga viti 1999 si dhe strategjinë për të ardhmen. Nga ana e tij, ministri Quni shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për kontributin e madh të HALO Trust – Programi në Kosovë, në misionin e tyre të shenjtë, që nga paslufta, në mbrojtjen e jetëve të qytetarëve tanë duke eliminuar dhe minimizuar vatrat me potencial të lartë rreziku nga minat dhe mjetet tjera eksplozive të pashpërthyera të mbetura që nga lufta e fundit. Gjithashtu, ai vlerësoi lart edhe kontributin e madh të personelit të saj në edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth minave tokësore dhe mjeteve tjera eksplozive të pashpërthyera si dhe rikthimin e qëndrimin e sigurt në vendbanimet e tyre. Ministri Quni e vlerësoi si shumë të rëndësishëm edhe bashkëpunimin e ngushtë të HALO Trustit me Qendrën Koordinuese të Deminimit të FSK-së, mbështetjen e pandërprerë profesionale dhe ofrimin e përvojave operative për kontingjentin e Kompanisë së Deminimit të FSK-së, me zotimin e përbashkët me znj. Meader për thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Në fund, ministri Quni shprehu respektin e madh për misionin 32- vjeçar të HALO Trust me programe të veçanta në pjesën dërmuese të zonave pas konfliktit në shërbim të miliona jetëve civile anekënd Botës. Gjatë vizitës, ministri Quni shoqërohej nga drejtori i Qendrës Koordinuese të Deminimit të FSK-së, Ahmet Sallova, këshilltari i tij ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi dhe zyrtarja e lartë e kabinetit znj.Martina Dedaj-Kqira. HALO Trust është një organizatë bamirëse anglo-amerikane, e cila merret me asgjësimin e mbetjeve eksplozive të pashpërthyera të pasluftës, në veçanti me minat tokësore. Kjo organizatë, aktualisht operon me rreth 6000 çminues në të gjithë Botën.

Diversiteti etnik dhe kulturor, vlerë e veçantë në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK

Prishtinë, 28 tetor 2020. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni priti në takim përfaqësuesit e lartë institucionalë dhe politikë të komunitetit turk, ministrin e Zhvillimit Rajonal, Enis Kervan, deputetin, njëherësh kryetarin e Partisë Demokratike Turke (KDTP), Fikrim Damka dhe deputeten Fidan Brina Jilta. Në fillim, ministri Quni i njoftoi mysafirët me zhvillimet aktuale në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK si dhe me objektivat e tij për të ardhmen, me fokus në politikat për integrimin e komuniteteve joshumicë. Ndër të tjera, ai theksoi marrëdhëniet e shkëlqyera ndërnjerëzore dhe ndërkolegiale në mes zyrtarëve dhe pjesëtarëve nga radhët e të gjitha komuniteteve. Ministri Quni çmoi lart angazhimin edhe të pjesëtarëve të komunitetit turk në të gjitha nivelet e përgjegjësisë, duke çmuar si vlerë e shtuar në relacion me shtetin, kombin dhe ushtrinë turke si partnere jona shumë e rëndësishme në zhvillimin e përgjithshëm të ministrisë dhe forcave tona. Në fjalët e tyre, mysafirët shprehën vlerësimin e lart për të gjitha të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së si dhe bashkëpunimin e ngushtë me shtetin, ministrinë homologe dhe forcat turke. Ata shprehën interesimin dhe ofruan autoritetin e tyre për të mbështetur dhe kontribuar në FSK me integrimin e kuadrove të pjesëtarëve nga radhët e komuniteti turk. Gjatë takimit, ministri Quni shoqërohej nga këshilltari i tij politik për çështje të komuniteteve, Berkant Curi.

FSK-ja ndihmon komunat në përballje me pandeminë Covid-19

Prishtinë, 12 Nëntor 2020. Në kazermën "Adem Jashari", respektivisht në Qendrën Mjekësore të FSK-së, sot u mbajtë ceremonia e pranim-dorëzimit të donacionit nga Republika Federale e Gjermanisë me materiale mjekësore për përballimin e krizës së pandemisë COVID-19. Në emër të shtetit dhurues, donacionin e dorëzoi drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjeneral brigade Frank Best, kurse në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, donacionin e pranoi zëvendës komandanti i FSK-së, gjeneral major Enver Cikaqi në shoqërim të drejtorit të Qendrës Mjekësore të FSK-së, dr. Shkëlzen Syla. Më pas, bazuar në planin paraprak të QKMFSK, me urdhër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama si dhe në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me stafin e lartë ushtarak gjerman, filloi operacioni i shpërndarjes së materialeve të donacionit përkatës në komunat e planifikuara të banuara nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Kontingjenti i parë i donacionit përkatës, sot iu dorëzua Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë, ku të pranishëm ishin edhe gjeneral Cikaqi, gjeneral Best dhe dr.Syla të pritur nga zëvendëskryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka me bashkëpunëtorë si dhe stafi drejtues i Qendrës Mjekësore përkatëse. Në fillim, z. Mujka në emër të stafit të QKMF-së dhe qytetarëve të komunës së tij, shprehu mirënjohjen dhe falënderimin e madh për FSK-në dhe shtetin gjerman për ndihmën e ofruar e shumë të nevojshme në këtë periudhë. Nga ana e tyre, gjeneral Cikaqi dhe dr. Syla, i njoftuan të pranishmit me përmbajtjen e projektit dhe shprehën zotimin për vazhdimin e aktiviteteve të FSK-së me të gjitha aftësitë dhe kapacitetet operacionale në dispozicion për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile dhe qytetarëve tanë në përballje me krizën e pandemisë COVID-19 dhe nevoja tjera. Shpërndarja e materialeve mjekësore përkatëse do të vazhdoj edhe gjatë pesë ditëve të ardhshme në komunat: Viti, Hani i Elezit, Kaçanik, Mamushë, Dragash, Suharekë, Obiliq, Vushtrri, Kamenicë, Shtërpcë, Drenas, Lipjan, Fushë Kosovë, Junik, Deçan, Skenderaj, Istog, Vitomiricë dhe Podujevë.



Certifikohen skuadrat e këmbësorisë për mbrojtje territoriale



Istog, 30 tetor 2020. Në poligonin e stërvitjeve kolektive taktike të FSK-së në Babaj të Bokës, u realizua stërvitja fushore „Ujku Alfa-1". Në këtë stërvitje pesëditore u demonstruan shkathtësitë operuese të njësiteve të Komandës së Regjimentit të Parë të Këmbësorisë të Forcave Tokësore për certifikimin e tyre në detyrat e mbrojtjes territoriale. Në këtë ngjarje të veçantë, morën pjesë ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj dhe oficerë të tjerë të lartë të FSK-së. Ata u pritën nga komandanti i Regjimentit të Parë të Këmbësorisë, nënkolonel Albert Kuçi dhe stafi i tij, i cili i njoftoi lidhur me aktivitetet e zhvilluara në stërvitjen përkatëse, të arritur, sfidat dhe qëllimin final të kësaj stërvitjeje. Në vijim, para fillimit të demonstrimit stërvitor, fjalën e mori ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni, i cili duke përshëndetur trupat e Regjimentit të parë të Këmbësorisë për këtë arritje të veçantë ndër të tjera u shpreh se, Forca e Sigurisë e Kosovës ka shënuar një pikë kthese në historinë e saj, duke certifikuar aftësitë dhe kapacitetet e para ushtarake në nivel skuadre për mbrojtjen territoriale të vendit dhe pjesëmarrjen dinjitoze krah për krah me forcat aleate në operacione paqeruajtëse. „Certifikimi i këtyre skuadrave shënon përmbushjen e detyrave më të rëndësishme, deri më tani, që dalin nga Plani Gjithëpërfshirës i Tranzicionit. Këtë hap cilësor, me krenari mund ta quajmë një ngjarje të veçantë në historinë e forcave tona", - theksoi më tej ministri Quni. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama vlerësoi lart certifikimin e skuadrave të para të Regjimentit të Parë të Këmbësorisë, si një arritje të veçantë, që i dedikohet punës, disiplinës, sakrificës dhe profesionalizmit të të gjithë personelit të kësaj njësie, për të cilët, ai shprehu edhe falënderimet dhe mirënjohjen e tij personale. „Procesi i certifikimit, më shumë se krenari për ne, nënkupton përgjegjësi dhe sakrificë. Ne do të vazhdojmë tutje deri në realizimin e plotë të objektivave strategjikë dhe vizionit tonë për të ardhmen", - tha ndër tjera gjeneral Rama. Kompania A e Regjimentit të Parë të Këmbësorisë, nga data 26.10.2020, gjatë stërvitjes për mbrojtje territoriale iu nënshtrua një sërë skenarësh, të përgatitur mbi praktikat më të mira të stërvitjes dhe vlerësimit të vendeve të NATO-s dhe të bazuar në doktrinat e Aleancës të forcave të këmbësorisë, duke testuar kapacitetet zotëruese operacionale, por edhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e luftimit. Demonstrimi stërvitor u përmbyll me zhvillimin e operacionit luftarak në stacionin e fundit dhe konfirmimin e suksesit të plotë nga ana e gjeneral Hadërgjonajt. Në këtë atmosferë të veçantë u ndanë edhe gradat për dy oficerë të angazhuar në stërvitje, respektivisht kapitenin e ri Dritan Hoti dhe togerin e ri Valdrin Pollomi.



Përmbyllje e stërvitjes fushore „Ujku vigjilent-02“

Prishtinë, 25 Nëntor 2020. Në Poligonin e stërvitjeve taktike në fshatin Cernushë, u realizua Stërvitja Fushore katër ditore “Ujku vigjilent-02 ” me demonstrimin stërvitor përmbyllës të Kompanisë së Mekanizuar të Regjimentit të Tretë të Forcave Tokësore të FSK-së. Për të parë nga afër demonstrimin e operacioneve stërvitore, ishin ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj dhe atasheu ushtarak i SHBA-së, major Bret Wisecup. Ata u pritën nga zëvendëskomandanti i Regjimentit të Tretë, major Ilir Beqiri, dhe komandanti i Kompanisë së Mekanizuar, toger Bardhyl Dugolli, të cilët njoftuan lidhur me konceptin, njësitë e angazhuara, përbërjen e tyre, organizimin, skenarët si dhe kurset e veprimit të cilat u ekzekutuan në stërvitjen përkatëse. Pas demonstrimit stërvitor, pjesëtarëve të task-forcës pjesëmarrëse në stërvitje iu drejtua ministri i Mbrojtjes, Anton Quni i cili shprehu impresionet e tij për nivelin e lartë të profesionalizimit të demonstruar gjatë stërvitjes. “Ky nivel profesional , kjo shkallë e angazhimit dhe përkushtimit janë faktori determinues i besimit të plotë në ju. Kërcënimet ndaj nesh fare nuk na brengosin sepse fitues është ai që mbron vendin e vet.” tha ndër të tjera ministri Quni. Nga ana e tij, gjeneral Rama shprehu vlerësimin e lartë për shkallën e profesionalizmit të demonstruar duke theksuar se kjo e arritur me standardet bashkëkohore na forcon besimin në qëllimit tonë, integrimin në NATO me forca të ndërveprueshme për operacione të përbashkëta me forcat aleate. “Sa më parë të realizojmë këtë qëllim do të jetë më mirë jo vetëm për vendit tonë por edhe rajonin e më gjerë” tha ndër të tjera gjeneral Rama. Pas demonstrimit të operacioneve urbane, nga ana e ministrit Quni dhe gjeneral Ramës, u përurua solemnisht, Poligoni i Stërvitjeve për Operacione Urbane të FSK-së. Poligoni përkatës i përuruar sot ka filluar së ndërtuari para një viti dhe plotëson të gjitha kushtet për trajnim deri në nivel kompanie. Ky moment ishte shumë domethënës pasi që ideator për ndërtimin e këtij poligoni ishte nënoficeri i dalluar i FSK-së, tashmë i ndjerë, kapter Baki Ejupi. Stërvitja fushore “Ujku vigjilent” shënon edhe përfundimin e ciklit të trajnimit tremujor të kompanisë përkatëse me mbështetjen edhe të AIR MEDEVAC të Ushtrisë Amerikane. Ky është aktiviteti i radhës i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së në kuadër të procesit të zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen e territorit, si detyrim kryesor ligjor i saj.











FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 94 • 4 Janar 2021 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Vjosa Osmani, presidentja në detyrë uron ushtarakët e FSK-së

Prishtinë, 30 dhjetor 2020. Në kazermën „Adem Jashari“, në cilësi të presidentes në detyrë të Republikës së Kosovës si dhe komandantes supreme të FSK-së, zonja Vjosa Osmani, në vigjilje të fundvitit, sot iu adresua ushtarakëve dhe ushtarakeve të FSK-së. Në prani të ministrit të Mbrojtjes z. Anton Quni dhe me pritje të togut të rreshtuar të Gardës Ceremoniale, në përcjellje të Orkestrës Frymore të FSK-së, ajo u shoqërua nga komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama. Në adresimin e saj, presidentja në detyrë, znj. Osmani, shprehu mirënjohjen për të arriturat e FSK-së për shërbimin e jashtëzakonshëm gjatë vitit të vështirë që po lëmë pas. Ajo me këtë rast shprehu ngushëllimet e saj për ndarjen nga jeta të kolonel Gyrner Muratit, i cili u nda nga ne para dy ditësh. Ndër të tjera, ajo shprehu vlerësimin e lartë për gatishmërinë dhe përkushtimin me profesionalizëm të lartë të pjesëtarëve të FSK-së në shërbim të institucioneve dhe qytetarëve tanë. Përveç shprehjes së gatishmërisë së saj për ndihmë me kapacitetet e specializuara të FSK-së adresuar autoriteteve shtetërore kroate pas tërmetit, ajo nënvizoi të arriturat kryesore të FSK-së gate vitit 2020. Gjithashtu, znj. Osmani theksoi vizionin shtetëror dhe të vet FSK-së për ndërtimin dhe zhvillimin e një force moderne, bashkëpunuese e ndërvepruese me forcat aleate perëndimore, para së gjithash me SHBA-të, me orientim strategjik për anëtarësim në NATO për të ofruar kontributin e saj për paqen, sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe më gjerë. Në fund, znj. Osmani shprehu kujtimin dhe krenarinë për rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të komandantit legjendar Adem Jashari në luftën për liri dhe pavarësi të atdheut duke e ndërlidhur edhe me datën e sotme, Ditën e Veteranit, e cila ka pikë referimi pikërisht mbrojtjen e armatosur nga Familja Jashari më 30 dhjetor 1991.



Ministri Anton Quni priti në vizitë ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Italisë



Prishtinë, 24 dhjetor 2020. Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, me ceremoni të lartë ushtarake, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, priti në vizitë zyrtare homologun e tij, ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Italisë, z. Lorenzo Guerini së bashku me delegacionin e tij të lartë ministror, diplomatik dhe ushtarak. Ministri Quni e falënderoi ministrin Guerini, duke i shprehur kënaqësi të veçantë për këtë vizitë në rrethana kaq të vështira të krijuara nga kriza e pandemisë. Në fjalën e tij, ministri Quni, gjithashtu shprehu mirënjohjen e lartë për Republikën e Italisë, si vend mik, në mbështetjen e ofruar në të gjitha periudhat e vështira në të cilat ka kaluar vendi dhe populli i Kosovës. Ai nënvizoi përkrahjen e madhe gjatë dhe pas luftës, në ndërtimin dhe arritjet e deritashme të vendit e posaçërisht Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Në vazhdim, ministri Quni shprehu mirënjohjen e lartë për rolin dhe kontributin e madh në sigurinë e përgjithshme të vendit dhe rajonit të kontingjentit ushtarak italian në kuadër të KFOR-it, të udhëhequr me sukses nga gjeneralët e shumtë italianë duke theksuar edhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me ish-komandantin e KFOR-it, gjeneral Risin të pasuar me të njëjtin bashkëpunim edhe me komandantin aktual të KFOR-it gjeneral major Franco Federici.

(vijon në faqen 3)

Nënshkruhet memorandum mirëkuptimi mes Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Jordanisë



Prishtinë, 23 dhjetor 2020. Pas procesit paraprak bashkëpunues përgatitor, u zyrtarizua partneriteti dypalësh mes Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Jordanisë në fushën e mbrojtjes. Memorandumi i mirëkuptimit u nënshkrua në distancë për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19, nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Jordanisë, gjeneral major Yousef A. Alhnaity, në emër të palës jordaneze, dhe nga komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtënant Rrahman Rama, me autorizim të ministrit Quni, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës. Si marrëveshje dypalëshe e bashkëpunimit, e 15-ta me radhë e Republikës së Kosovës me vendet tjera në fushën e mbrojtjes, ka për qëllim bashkëpunimin në fushat si: luftën kundër terrorizimit, operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, arsimimin dhe stërvitjet ushtarake, hulumtimin në industrinë e mbrojtjes si dhe shkëmbimin e përvojave në nivel ekspertësh. Të pranishëm gjatë nënshkrimit të këtij memorandumi ishin edhe ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe sekretarja e Përgjithshme e MM-së, znj. Rozafa Ukimeraj.

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni pjesë e konferencës ndërkombëtare „Bashkëpunimi Mbrojtës i Evropës Qendrore“



Prishtinë, 16 dhjetor 2020. Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, përmes video komunikimit, ishte pjesëmarrës i konferencës „Bashkëpunimi Mbrojtës i Evropës Qendrore“, që u mbajt në Sllloveni. Pjesëmarrja e Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës në këtë takim ishte një mundësi e mirë për të shprehë qëndrimet dhe objektivat e Kosovës, në fushën e bashkëpunimit dhe sigurisë me vendet evropiane si dhe gatishmërinë për të dhënë kontributin në fushën e sigurisë, në nivel rajonal, evropian dhe global. Duke trajtuar çështjen e pandemisë COVID-19 dhe pasojave që ka lanë ajo tek qytetarët e shteteve evropiane, si dhe sfidat që i ka nxjerrë përballë qeverive të këtyre shteteve në menaxhimin e kësaj gjendjeje, ministri Quni, u shpreh: „Mësimi më i rëndësishëm që duhet të mësojmë jo vetëm nga kjo pandemi, por edhe nga sfidat tjera, të tilla, si; emigracioni i paligjshëm masiv, luftëtarëve terroristë ndërkombëtarë, nuk kanë kufij gjeografikë, politikë ose administrativë. Prandaj, si përgjigjja ndaj tyre, ashtu edhe bashkëpunimi duhet të jenë pa kufij. Sfida si këto janë domethënëse, dhe duhet të adresohen në mënyrë kolektive“. Duke folur për aspiratat e qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës, për të qenë pjesë e integruar e botës Euro-Atlantike, më tej, ministri Quni, deklaroi se: Qëllimi dhe objektivi ynë strategjik është që sa më parë të bëhemi pjesë e iniciativave të ndryshme rajonale, si një anëtare e plotë. „Ky është një parakusht dhe është në përputhje me aspiratat tona për t'u integruar në proceset euroatlantike dhe unë mund t'iu siguroj që të gjithë krahët politikë në Kosovë, janë të orientuar absolutisht drejt integrimit euroatlantik, dhe ne, po punojmë në këtë drejtim. Ne jemi të vetëdijshëm për këtë sfidë dhe do të bëjmë të gjitha përpjekjet tona për ta arritur atë”. Po ashtu, ministri Quni shprehu gatishmërinë që Kosova të japë kontributin e vet edhe përmes angazhimeve konkrete në ruajtjen e paqes, krah për krah shteteve të Aleancës Veri Atlantike, në të mirë të paqes së përgjithshme. „Është një fakt i njohur, që për momentin Kosova është një konsumator i sigurisë, i siguruar nga angazhimi operativ CSDP (Siguria e Përbashkët dhe Politika e Mbrojtjes) përmes EULEX-it, dhe operacionet e NATO-s/ KFOR-it, dhe unë mund të konfirmojë gatishmërinë e qeverisë sonë për të bashkëpunuar me ta. Por ne nuk duam të mbetemi vetëm konsumator“. Në fjalën e tij, ministri Quni një rëndësi të veçantë i kushtoi edhe gatishmërisë së Kosovës për të bashkëpunuar edhe më ngushtë me shtetet evropiane, me institucionet evropiane të sigurisë për të dhënë kontributin edhe Kosova si shtet. „Unë do të doja ta përdor këtë forum për të shprehur dëshirën tonë për të kontribuar në misionet ndërkombëtare dhe operacionet e drejtuara nga BE-ja. Dhe ne, si qeveri do të ndërmarrim hapat e nevojshëm përpara për të arritur këtë qëllim”. Në përmbyllje të fjalës së tij, ministri Quni theksoi rëndësinë e ndihmës dhe përkrahjes nga vendet evropiane për të realizuar këto qëndrime dhe objektiva, që do të ishin jo vetëm në të mirë të sigurisë së Kosovës, vet Evropës dhe sigurisë së përgjithshme. „Si përfundim, unë do të doja të ritheksoj se Kosova e konsideron këtë forum si një platformë të vlefshme për rritjen e partneriteteve dhe nxitjen e procesit të integrimit euroatlantik, dhe unë do të doja ta shfrytëzoja këtë mundësi për të kërkuar mbështetjen tuaj për Republikën e Kosovës“.

Admirali Robert Hranj falënderon gjeneral Ramën për gatishmërinë për të ndihmuar Kroacinë



Zagreb, 30 dhjetor 2020. Pas letrës së komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, adresuar homologut të tij, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kroacisë, admiralit Robert Hranj, ku shpreh shqetësimin e thellë pas pasojave të tërmetit në Kroaci si dhe vullnetin dhe gatishmërinë e plotë për dërgimin e njësive të specializuara për operacionet e kërkim-shpëtimit, ka ardhur përgjigja e admiralit Hranj me përmbajtjen si në vijim: “ I nderuar gjenerallejtënant Rama, Kam marrë letrën Tuaj dhe ne të gjithë jemi mirënjohës për mbështetjen vetëmohuese të ofruar nga Forca e Sigurisë e Kosovës. Forcat e Armatosura Kroate po ndihmojnë dhe mbështesin popullsinë lokale me aftësitë dhe burimet tona, dhe ne e vlerësojmë reagimin tuaj të menjëhershëm. Ne nuk do të hezitojmë të kërkojmë ndihmë nga ekipet tuaja nëse është e nevojshme.

Edhe një herë, faleminderit, faleminderit Kosovë!”
Sinqerisht,
Admirali Robert Hranj
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Forcat e Armatosura Kroate

Mesazhi i urimit i komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama për Vitin e Ri 2021



Prishtinë, 31 dhjetor 2020.

Të dashur qytetarë
të vendit tim,

Të dashur ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe staf civil i FSK-së,

Të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të forcave partnere.

Në prag të këtij fundviti, në një periudhë shumë sfiduese për vendin dhe botën, është koha që të reflektojmë dhe të përgatitemi për vitin që po vjen. Shërbimi vetëmohues dhe fryma ekipore janë vlerat që na mundësuan të luftojmë me besim të plotë se do ta fitojmë betejën me pandeminë. Prandaj me po të njëjtin vullnet dhe përkushtim duhet të vazhdojmë tutje.
Në këtë ditë feste, shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për besimin që kanë ndaj nesh, duke i siguruar që FSK-ja do të vazhdojë të punojë me përkushtim edhe më të madh që ne të jetojmë në një vend të sigurt. Duke reflektuar në sukseset tona si FSK gjatë vitit 2020, dua t’ i përgëzoj të gjithë ushtarët, nënoficerët, oficerët dhe stafin civil për punën e palodhshme në shërbim të atdheut. Një falënderim të veçantë u shpreh familjeve të pjesëtarëve të FSK-së për sakrificën që po e bëjnë në mbështetje të objektivave tona. Ju jemi përjetësisht mirënjohës! Kuptohet që suksesi ynë do të ishte i paimagjinueshëm pa mbështetjen e partnerëve tanë, prandaj dua të ritheksoj që suksesi ynë është edhe suksesi i tyre. Duke kujtuar brezat që sakrifikuan jetën e tyre që ne sot të festojmë të lirë dhe duke shprehur respektin më të lartë për familjet e tyre, uroj që viti 2021 të na gjejë të bashkuar më shumë se kurrë!

Gëzuar viti 2021, festofshi me shëndet!

Me respekt,
Gjenerallejtënant
Rrahman Rama

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma “Adem Jashari”, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ministri Anton Quni priti në vizitë ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Italisë

(vijon nga faqja 1)



Ai theksoi edhe rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi dypalësh me Ministrinë e Mbrojtjes së Italisë dhe Forcat e Armatosura të saj, duke pasur parasysh përvojën e madhe italiane në procesin e integrimeve euroatlantike dhe në ngritjen dhe zhvillimin e operacionalitetit ushtarak në përgjithësi. Në vazhdim, ministri Quni shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë të ushtarakëve italianë në cilësi të këshilltarëve dypalësh dhe atyre në kuadër të Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s, që nga fillimi i ndërtimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Eksperiencën e tyre, ai e vlerësoi shumë të rëndësishme, duke pasur parasysh fokusin në ngritjen e forcave të ndërveprueshme për pjesëmarrje cilësore në operacione paqeruajtëse. „Pjesëmarrja në operacionet e paqes është ndër detyrat kryesore ligjore të FSK-së, andaj edhe synim yni është zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat italiane dhe forcat tjera të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s. Ky synim do të kurorëzohet me ofrimin e mundësisë për dhënien e kontributit tonë në kuadër të forcave shumëkombëshe për paqen, stabilitetin dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë“, - tha ndër të tjera ministri Quni. Nga ana e tij, ministri Guerini, falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe ndjenjën e veçantë të vizitës në prag të krishtlindjeve në një vend mik. Ai e përgëzoi ministrin Quni për të gjitha të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së duke konfirmuar angazhimin e Republikës së Italisë për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë dhe rajon përmes KFOR-it. Ai në vazhdim shprehu interesimin e tij për shtimin e dinamikës për implementimin e memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar para dy viteve në mes dy ministrive dhe shprehu zotimin e tij për angazhimin dhe përkushtimin maksimal për të mbështetur vizionin e lidershipit të Ministrisë dhe FSK-së në planin politik, diplomatik dhe atë ushtarak për të ardhmen. „Ju siguroj se Republika e Italisë do të vazhdojë të mbështesë në mënyrë aktive perspektivën euroatlantike të Kosovës, duke theksuar se do të intensifikohen marrëdhëniet dhe bashkëpunimi dyplalësh në funksion të interesave tona të përbashkëta”,- tha ndër të tjera, ministri Guerini. Në vazhdim të diskutimeve, dy ministrat u pajtuan që ndër hapat e parë të viti të ardhshëm të jenë vizitat e ndërsjella të dy shefave të mbrojtjes, respektivisht gjeneral Ramës dhe gjeneral Vecciarelli, për të konkretizuar aktivitetet e bashkëpunimit dypalësh. Në fund, të dy ministrat shkëmbyen mesazhe urimi për festën e Krishtlindjeve me lutjet dhe dëshirat për vit më të mbarë për qytetarët, stafet e ministrive të të dy forcave, ushtarakët italian dhe të gjithë ushtarakët e KFOR-it me shërbim në Kosovë. Gjatë vizitës, ministri Guerini shoqërohej nga delegacioni i përbërë nga: shefit i Mbrojtjes së Italisë, gjeneral Enzo Vecciarelli, shefi i Shtabit të Operacioneve të Përbashkëta, admirali Pier Federico Bisconti, komandant i KFOR-it, gjeneral major Franco Federici, ambasadori i Italisë në Kosovë, Nicola Orlando, zv. shefi i Kabinetit për Politikë Ushtarake, admirali Gianfranco Annunziata, atasheu i Mbrojtjes në Kosovë, kolonel Giuseppe Montalto dhe këshilltari diplomatik i ministrit, Massimo Marotti. Në anën tjetër, delegacioni i ministrit Quni përbëhet nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarja e përgjithshme, Rozafa Ukimeraj, zv. komandanti i FSK-së, gjeneral major Enver Cikaqi, shefi i kabinetit, Jashar Ramadani, këshilltari ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrime Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha dhe zyrtarja e lartë e kabinetit, Martina Dedaj- Kqira.

Ministri Quni dhe gjeneral Rama iu adresuan mediave në konferencën e fundvitit 2020



Prishtinë, 28 dhjetor 2020. Ministri i Mbrojtjes Anton Quni dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në konferencën e fundvitit iu adresuan mediave dhe gazetarëve të pranishëm. Me këtë rast, ministri Quni në ekspozenë e fundvitit prezantoi të arriturat kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, për vitin 2020, duke shprehur kënaqësinë për aktivitetet e realizuara në funksion të përmbushjes së objektivave të tij strategjike vjetore që ndikojnë fuqishëm në realizimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit dhe prioriteteve të Qeverisë së Republikës të Kosovës. Nga ana e tij, gjeneral Rama, u përqendruar në të arriturat e këtij viti në shkallën e gatishmërisë dhe efikasitetin e operacioneve të njësive të FSK-së, gjatë pandemisë COVID-19, si dhe operacionet tjera në funksion të mbështetjes ushtarake të autoriteteve civile qendrore, lokale dhe qytetarëve tanë pa dallim. Në vazhdim ministri Quni, tha: „Në cilësi të bashkëkombësit, bashkëluftëtarit, bashkëveprimtarit e bashkëpunëtorit tuaj, kam nderin dhe privilegjin, por më shumë përgjegjësinë t’ju drejtohem në cilësinë e Ministrit të Mbrojtjes në prag të festave të fundvitit dhe përmbylljes së vitit të dytë të funksionimit si ushtri e vendit. Me kënaqësi mund të konstatoj se të gjitha objektivat, projektet dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2020, i kemi realizuar me sukses e në disa fusha edhe i kemi tejkaluar ato. Krahas obligimeve të përcaktuara në bazë të planit përkatës, me sukses arritëm të mirëmbajmë dhe avancojmë edhe më tej aftësitë dhe kapacitetet operacionale aktuale në mbështetje të autoriteteve shtetërore, civile dhe qytetarëve tanë. Bazuar në planin e tranzicionit kemi avancuar me sukses dhe tranzicionin dhe krijimin e kapaciteteve të para funksionale të mbrojtjes së territorit. Jemi në proces të përmbylljes me sukses të plotë të rekrutimit të 400 ushtarëve të rinj, duke ngritur përqindjen e përfaqësimit të komuniteteve në 8% e sidomos atë të komunitetit serb, si dhe duke ngritur përqindjen e gjinisë femërore në 11%. Krahas planit të arsimimit e trajnimit brenda vendit kemi realizuar edhe shkollimet, kurset, trajnimet, stërvitjet e garat ndërkombëtare me suksese të jashtëzakonshme të pjesëtarëve dhe njësive tona pjesëmarrëse, siç kemi edhe kuadrot e para nga West Point-i i famshëm të pasuar edhe me kuadrot e reja në të dhe Akademinë e Forcave Ajrore amerikane. Krahas vizitave, pritjeve, takimeve e kontakteve tjera zyrtare të niveleve më të larta me vendet partnere, kemi përfaqësuar Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat tona në Konferencën e Kartës së Adriatikut, A5-SHBA, me status të anëtarit vëzhgues, ku së shpejti shpresojmë të anëtarësohemi si anëtare me të drejta e përgjegjësi të plota, si dhe për herë të parë në iniciativën e Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Evropës Qendrore. Me sukses kemi arritur që të finalizojmë pjesën më të madhe të dokumenteve ligjore, doktrinarë, administrative dhe trajnuese për misionin e ri, bazuar në ligjet tona në fuqi dhe në përputhje me konceptet, standardet dhe doktrinën ushtarake të Forcave të Armatosura të SHBA-ve dhe të vendeve tjera partnere dhe anëtare të NATO-s. Objektiv tjetër yni është të ndërtojmë dhe të zhvillojmë forca të ndërveprueshme me forcat e vendeve të NATO-s dhe partnere të saj, duke besuar se së shpejti forcat tona do të angazhohen në operacione të përbashkëta paqeruajtëse për të ofruar kontributin tonë në të mirën e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Rezultatet e shkëlqyera dhe sukseset tona i vlerësojmë si produkt i angazhimit të përbashkët me partnerët tanë, me këshilltarët bilateral, me Ekipin Këshillëdhënës të NATO-s dhe me KFOR-in që gjithmonë ishin dhe janë me ne, gjatë tërë rrugëtimit tonë. Andaj të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të forcave e vendeve partnere iu shpreh vlerësimin më të lartë dhe mirënjohjen e thellë për angazhimin e dëshmuar që ministria dhe forca jonë të jenë edhe këtë vit, për të nëntën herë me radhë, imazhi i besueshmërisë më të lartë qytetare dhe shembulli i suksesit në kuadër të institucioneve të vendit dhe më gjerë. Në këtë moment të veçantë, edhe njëherë, shfrytëzoj rastin të falënderoj nga zemra forcat tona dhe ushtarët e NATO-s që shërbejnë me vetëmohim për sigurinë, mbrojtjen dhe kujdesin për vendin dhe qytetarët tanë“, përfundoi fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Anton Quni.

Në kazermën e FSK-së, në Gjilan

Në dyvjetorin e Ushtrisë së Kosovës zb



Prishtinë, 14 dhjetor 2020. Në dyvjetorin e zyrtarizimit të mandatit ushtarak të FSK-së, sot në kazermën e FSK-së në Gjilan, u mbajt ceremonia e zbulimit të mozaikut me portretin e heroit kombëtar, Agim Ramadani. Në ceremoninë përkatëse, morën pjesë ministri Anton Quni, zv.komandanti i FSK-së, gjeneral major Enver Cikaqi, familjarë të heroit Agim Ramadani, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, dhe ai i Obiliqit, Xhafer Gashi, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, ish-komandanti i Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së, Ahmet Isufi, familjarë të heronjve dhe dëshmorëve të kombit, veteranë të luftës së Brigadës 138 „Agim Ramadani“, etj. Me këtë rast, ministri Quni, në cilësi edhe të bashkëluftëtarit dhe mikut të ngushtë të heroit Agim Ramadani, theksoi se personaliteti madhështor i Agimit, mozaiku tashmë vepër e përmasave botërore dhe datës së sotme historike janë unike e që së bashku krijojnë ndërlidhjen e veçantë dhe me vlera të papërsëritshme. „Urdhrin e Komandant Katanës se edhe vetëm një ushtar nëse mbetet ka për detyrë që të formojë njësitë luftarake dhe të vazhdojë luftën deri në fund për çlirimin e Kosovës“, me simbolikën e fuqishme, e kemi përmbushur edhe sot me rreshtimin e njësisë elite të FSK-së të komanduar dhe udhëhequr nga ish-luftëtari i njësisë së Agimit, nënkolonel Albert Kuqi dhe djali i heroit Shkëlzen Haradinaj, nëntoger Luan Haradinaj dhe shumë e

Komandanti i KFOR-it, gjenerali Franco Federici u prit nga ministri Anton Quni



Prishtinë, 7 dhjetor 2020. Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni priti në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici. Duke falënderuar për mikpritjen, gjeneral Federici shprehu kënaqësinë e tij për të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, profesionalizmin e lartë të dëshmuar deri më tani si dhe nivelin e lartë të bashkëpunimit mes KFOR-it dhe FSK-së. Ndër të tjera, ai shprehu gatishmërinë e plotë për vazhdimin e këtij bashkëpunimi dhe rritjen e nivelit të marrëdhënieve të kultivuara nga paraardhësit e tij, me qëllimin e përbashkët nën moton „Të bëjmë progres së bashku si një i vetëm“. Nga ana e tij, ministri Quni duke e uruar gjeneralmajorin Federici për detyrën e re, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e lartë për misionin e KFOR-it në shërbim të sigurisë së vendit dhe ndikimin e tij të madh edhe në sigurinë rajonale. Ai siguroi gjeneralin Federici se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK janë ndërtuar dhe zhvillohen në konsistencë të plotë me normat, vlerat, parimet dhe standardet më bashkëkohore të vendeve të NATO-s si institucione nën kontrollin civil demokratik, me transparencë dhe llogaridhënie të plotë, si dhe forca me aftësi dhe kapacitete mbrojtëse në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim. „Këto parime, vlera dhe standarde janë ndërtuar dhe zhvillohen që nga fillimi nën monitorimin e NATO-s përmes Ekipi Këshillëdhënës të NATO-s, bashkëpunimit dypalësh me vendet partnere dhe bashkëpunimit profesional dhe institucional me KFOR-in“, - tha ndër të tjera ai. Në fund të dy u pajtuan për intensifikimin e bashkëpunimit, kontakteve dhe koordinimit të ndërsjellë për shkëmbimin e pikëpamjeve për çështjet me interes të përbashkët në kuadër të rolit dhe përgjegjësive institucionale.

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Qendrës së Inovacionit të Kosovës



Prishtinë, 16 dhjetor 2020. Sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, znj. Rozafa Ukimeraj dhe drejtori ekzekutiv i Qendrës së Inovacionit të Kosovës (Inovation Centere Kosova -- ICK), z. Uranik Begu, nënshkruan sot marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe ICK-së. Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin pa kompensim financiar mes MM/FSK-së dhe ICK-së, për interesat e zhvillimit të dy institucioneve përkatëse në fushën e ndërmarrësisë, inovacionit, aftësimit profesional, si dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Ministri Quni priti në takim vajzën e profesor Anton Çettës

Prishtinë, 21 dhjetor 2020. Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, priti sot në takim vajzën e profesorit të nderuar, veprimtarit të çështjes kombëtare, etnografit, folkloristit dhe udhëheqësit të Pajtimeve të Gjaqeve, Anton Çettës, znj. Donika Çetta dhe profesor Riza Krasniqin, bashkëpunëtor dhe bashkëveprimtar i pajtimeve të gjaqeve me profesor Anton Çettën. Ministri Quni, me këtë rast ka vlerësuar lart kontributin dhënë çështjes kombëtare të profesorit të nderuar Anton Çetta si dhe familjes së tij, duke shtuar, se: „Profesori Anton Çetta ishte studiues i kulturës popullore dhe kombëtare, ishte njëri ndër intelektualët dhe folkloristët më të shquar si punonjës shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, duke dhënë një kontribut të madh edhe në pajtimin e gjaqeve në Kosovë“. Nga ana e saj, znj. Donika Çetta, e ka falënderuar ministrin Quni, për angazhimin e madh që po bën në ngritjen e Ushtrisë së Kosovës, dhe në shenjë mirënjohjeje i dhuroi Kompletin e veprave letrare (13 vëllime) të babait të saj.

Në kazermën e FSK-së, në Gjilan

ulohet mozaiku i heroit Agim Ramadani

shumë pasardhës të heronjve e martirëve të lirisë", tha ndër të tjera ministri Quni. Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili vlerësoi lart ideatorët dhe realizuesit e projektit, duke theksuar se „Agimi zbarkoi aty ku e ka vendin, duke shërbyer gjithmonë si inspirues dhe motivues për ushtarët e rinj dhe shëmbëlltyrë e flijimit madhështor për liri". Nga ana e tij, realizuesi i mozaikut, Besart Gashi shprehu me emocione nderin dhe respektin që ka për heroin Agim Ramadani dhe të gjithë të rënët për liri, duke shprehur se ndjehet i privilegjuar që ka arritur të realizojë projektin e tij tashmë me përmasa ndërkombëtare të vendosur në vend dhe ngjarje të veçantë. Në emër të familjes së heroit, Agim Ramadani, të pranishmit i përshëndeti vëllai i heroit, Bekim Ramadani, i cili shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin për projektin dhe organizimin e shkëlqyeshëm, duke nënvizuar se „idealet e Agimit deri në flijim dhe gjithë të rënëve për liri janë vlera më të shtrenjta që reflektojnë në të tashmen dhe të ardhmen tonë". Në fund, zbulimi i mozaikut u bë nga ministri Quni, gjeneral Cikaqi, kryetarët Haziri dhe Gashi, familjarët e heroit Agim Ramadani, si dhe të pranishmit tjerë përfaqësues, duke madhështuar ambientin e kazermës të Regjimentit të Parë të Këmbësorisë të Forcave Tokësore të FSK-së. Kjo vepër artistike punuar nga artisti Besart Gashi, me mbështetjen financiare të humanistit Muhamet Hajrullahu, për shkak të përmasave dhe mënyrës krijuese unike, me kapëse teli, ka hyrë zyrtarisht në librin e rekordeve „Guinness" më 22 gusht 2020.



Gjenerali Rrahman Rama ndan mirënjohje për personelin mjekësor të SHSKUK-së dhe IKSHPK-së



Prishtinë, 29 dhjetor 2020. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama i shoqëruar nga drejtori i Qendrës Mjekësore të FSK-së, dr. Shkëlzen Syla, ndan mirënjohje për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike me motivacion për bashkëpunimin e ngushtë me Qendrën Mjekësore të FSK-së, mbështetjen për FSK-në si dhe shërbimet dhe kujdesin e vazhdueshëm të ofruar për personelin e FSK-së gjatë këtij viti në krizën e pandemisë COVID-19. Në pritjen e veçantë për drejtuesit e SHSKUK-së, kryesuar nga ana e u.d. drejtorit të saj, dr. Valbon Krasniqi, të bërë në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, përveç gjeneral Ramës dhe dr. Sylës e pranishme ishte edhe këshilltarja e NALT-it për shëndetësi, nënkolonel, Anika Benesch. Me këtë rast, gjeneral Rama falënderoi dhe shprehu mirënjohjen e lartë për personelin mjekësor të SHSKUK-së dhe IKSHPK-së, të cilët edhe pse gjatë tërë kohës ishin "në vijën e parë të frontit", ofruan kujdesin e veçantë për personelin e FSK-së. Gjeneral Rama e vlerësoi shumë të rëndësishëm bashkëpunimin ndërinstitucional në përgjithësi dhe atë me SHSKUK-në dhe IKSHPK-në, në periudhën e krizës së pandemisë COVID-19 në veçanti. Nga ana e tij, u.d drejtori dr. Valbon Krasniqi dhe drejtuesi i bordit të SHSKUK dr. Xhevat Jakupi, shprehën vlerësimin e lartë të bashkëpunimin me Qendrën Mjekësore të FSK-së, respektivisht, drejtorin e saj, dr. Shkëlzen Sylën si dhe mirënjohjen për angazhimin, përkushtimin dhe mbështetjen me materiale, pajisje mjekësore dhe personel profesional gjatë gjithë periudhës së menaxhimit të krizës së pandemisë për nevojat e tyre. Në fund, gjeneral Rama, dr. Krasniqi, dr. Syla dhe dr. Jakupi, u pajtuan që bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve përkatëse, të intensifikohet edhe më shumë në funksion të interesit të ndërsjellë për përmbushjen sa më të suksesshme të detyrave dhe përgjegjësive institucionale dhe profesionale. Vizita u përmbyllë me urimet e ndërsjella për vitin e ri si dhe me vizitën në mjediset e Qendrës Mjekësore të FSK-së. Me motivacionin e njëjtë, gjeneral Rama u ka ndarë mirënjohje edhe klinikave të SHSKUK-së dhe spitaleve rajonale të vendit.

Në Ministri të Mbrojtjes

U mbajt takimi publik për diskutimin e Projekt-Strategjisë së Mbrojtjes



Prishtinë, 29 dhjetor 2020. Në Ministrinë e Mbrojtjes, organizuar nga ana e Grupit Punues për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes, u mbajt takimi publik në kuadër të procesit të konsultimit dhe komunikimit publik për hartimin e strategjisë përkatëse. Takimi u kryesua nga ana e Grupit punues për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes, kryesuar nga gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, i cili duke shprehur mirëseardhjen dhe në fjalën e tij prezantoi kronologjinë e shkurtër të procesit të hartimit, qasjen, metodologjinë, aktorët bashkëpunues vendor dhe ata këshillëdhënës ndërkombëtar, rëndësinë e projekt-strategjisë, si dhe hapat e synuar për të ardhmen. Me një prezantim të shkurtër, kolonel Haki Hoti i njoftoi të pranishmit me përmbajtjen kryesore, me theks të veçantë në parimet, qëllimin dhe objektivat e Projekt-Strategjisë së Mbrojtjes. Në vazhdim, u zhvilluan diskutime shumë përmbajtjesorë me qasje të përgjegjshme nga ana e pjesëmarrësve. Në takimin përkatës me diskutimet e tyre të frytshme kontribuuan kryesuesja e Komisionit për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, përfaqësuesi nga Zyra e Kryeministrit për Planifikim Strategjik, zyrtare, si dhe profesionale e akademike nga ana e pjesëmarrësve. Në takimin përkatës me diskutimet e tyre të frytshme kontribuuan kryesuesja e Komisionit për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, përfaqësuesi nga Zyra e Kryeministrit për Planifikim Strategjik, Kushtrim Canolli, përfaqësuesi nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Bekim Podrimçaku, përfaqësuesi nga Qendra Norvegjeze e Integritetit për Sektorin e Mbrojtjes (CIDS), dr. Florian Qehaja, përfaqësuesit nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Mentor Vrajolli dhe Plator Avdiu, përfaqësuesi nga Policia e Kosovës, kolonel Riza Shillova, përfaqësuesi nga Universitetit i Prishtinës, prof. dr. Hasim Rushiti, përfaqësuesi nga Ministria e Financave, Albian Krasniqi etj. Përveç tyre, të pranishëm ishin edhe përfaqësuesi i Zyrës së Presidentit, zyrtarët nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Në fund, nga ana e kryesuesit, anëtarëve të tjerë të Grupit punues si dhe të pranishmëve takimi u vlerësua shumë lart, duke u pajtuar që takime të ngjashme të kësaj natyre dhe këtij niveli të organizohen edhe për projekte të tjera në të ardhmen.

Me nderime të larta ushtarake u varros kolonel Gyrner Murati



Prishtinë, 30 dhjetor 2020. Në rrethana tragjike, më 28 dhjetor 2020 ka ndërruar jetë oficeri i FSK-së, kolonel Gyrner Murati. Gyrneri ka lindur më 15.01.1973 në Llapashticë të Ulët, Komuna e Podujevës. Gyrneri ka qenë pjesëtar i UÇK-së, në Zonën Operative të Llapit. Pas transformimit të UÇK-së, ka shërbyer si epror në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, dhe që nga themelimi në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në ditët e fundit, Gyrneri ishte shef i Departamentit të Komunikimit dhe Teknologjisë Informative në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së. Më 30 dhjetor 2020, në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, Sekretarja e Përgjithshme Rozafa Ukimeraj dhe stafi i lartë i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i FSK-së, bënë homazhe para arkivolit të të ndjerit, kolonel Gyrner Muratit. Me këtë rast, ministri Quni dhe gjeneral Rama u shprehën ngushëllimet më të thella familjarëve dhe bashkëpunëtorëve të kolonel Muratit. Ceremonia e varrimit të kolonel Muratit u mbajt në fshatin e lindjes në Llapashticë të Ulët të Podujevës, me nderime të larta ushtarake, në praninë e familjarëve, miqve, shokëve dhe kolegëve të FSK-së. Në emër të komandantit të FSK-së dhe të gjithë ushtarakëve fjalën e mori zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral major Enver Cikaqi, i cili pasi shprehu ngushëllimet për familjen, miqtë, shokët dhe kolegët e tij, vlerësoi shumë lart punën dhe kontributin e çmuar të kolonel Muratit në të gjitha periudhat e shërbimit të tij, si luftëtar i lirisë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe oficer në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. „Me veprimtarinë dhe kontributin e madh të kolonel Muratit janë krenarë jo vetëm familja por edhe ne bashkëpunëtorët e tij, si dhe do ta kujtojmë si një ushtarak profesionist dhe patriot të madh", tha ai. Gjeneral Cikaqi, në fund shprehu zotimin se punën dhe kontributin e kolonel Muratit do t'i vlerësojmë si gjurmë të pashlyeshme, të cilat Gyrneri i la në ndërtimin e Ushtrisë së vendit. Gjatë ceremonisë, folën edhe e bija Earta dhe vëllai i të ndjerit Skënderi, si dhe përfaqësuesi i organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së, z. Fahri Balaj. Në fund të ceremonisë u vendosën kurora të shumta lulesh nga miqtë, bashkëluftëtarët, kolegët, ushtarakët e shokët, nga të gjitha viset shqiptare.



Regjimenti i Dytë i Këmbësorisë përmbylli me sukses stër-vitjen fushore “Steel-02”



Prishtinë, 3 dhjetor 2020. Në zonën stërvitore afër kazermës së FSK-së “Ushtarët e NATO-s” në Istog u realizua demonstrimi stërvitor përmbyllës i Kompanisë 2A të Regjimentit të Dytë të Forcave Tokësore të FSK-së në kuadër të stërvitjes fushore katërditore “Steel-02 ”. Për të parë nga afër demonstrimin e operacioneve stërvitore, ishin ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama të shoqëruar nga zyrtarë e oficerë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Në fillim, ata u pritën nga komandantit të Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj dhe stafi i tij, i cili i falënderoi për vizitën, duke e vlerësuar lart këtë vizitë si shprehje e kujdesit të vazhdueshëm të lidershipit me ndikim të madh në motivimin për punë të suksesshme edhe në të ardhmen. Me këtë rast, komandanti i Regjimentit të Dytë, nënkolonel Astrit Haliti, dhe komandanti i Kompanisë 2A, kapiten Kreshnik Zeneli, njoftuan lidhur me qëllimin e stërvitjes, konceptin, njësitë e angazhuara, përbërjen e tyre, organizimin, skenarin dhe operacionet, të cilat u ekzekutuan në stërvitjen përkatëse. Pas demonstrimit stërvitor, pjesëtarëve të task-forcës pjesëmarrëse në stërvitje iu drejtua ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni, i cili shprehu përshtypjet e tij për nivelin e lartë të profesionalizimit të demonstruar gjatë stërvitjes. “Demonstrimi i juaj i sotëm më bënë shumë krenar dhe me besim të plotë se aftësitë dhe kapacitetet tuaja profesionale janë në nivelin më të lart për t’u përballur me të gjitha kërcënimet dhe rreziqet e formave të ndryshme bashkëkohore e shumë komplekse, që mund të cenojnë integritetin e vendit dhe sigurinë e qytetarëve tanë”,- tha ndër të tjera ministri Quni. Nga ana e tij, gjeneral Rama shprehu vlerësimin e lartë për nivelin e planifikimit dhe ekzekutimit të stërvitjes së sotme, duke theksuar se ky nivel i profesionalizmit të demonstruar është dëshmi e fuqishme se kemi forca të ndërveprueshme për operacione të përbashkëta me forcat aleate. “Misioni ynë fisnik dhe detyrat tona kërkojnë mund, sakrificë dhe përgjegjshmëri të lart. Për këtë duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshëm për të tashmen dhe të ardhmen e vendit, duke kujtuar gjithmonë të kaluarën tonë dhe mbështetjen e partnerëve tanë”, -tha ndër të tjera gjeneral Rama. Me këtë stërvitje, përmbyllet suksesshëm cikli i stërvitjeve të planifikuara të Regjimentit të Dytë të Këmbësorisë për këtë vit, dhe ishte aktiviteti i radhës i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së në kuadër të procesit të zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen e territorit, si detyrim kryesor ligjor i saj.

















FORCA JONË

*** Viti X • Nr. 95 • 4 Mars 2021 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton vendimin historik për dërgimin e kontingjentit të FSK-së në misione paqeruajtëse jashtë vendit



Prishtinë, 05 janar 2021. Ministria e Mbrojtjes si dikaster përgjegjës qeveritar për mbrojtje dhe siguri, ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe ligjore; ka bashkërenduar aktivitetet ndërinstitucionale dhe ndërshtetërore përmes rrugëve diplomatike, në mënyrë që të realizohet pjesëmarrja e FSK-së në misione paqeruajtëse ndërkombëtare, në kuadër të ushtrisë amerikane. Përkushtimi i vazhdueshëm, profesionalizmi dhe integriteti i FSK-së, si vlerat më të larta demokratike, përveç se e radhisin FSK-në në institucionin më të besueshëm nga qytetarët e Republikës së Kosovës, kanë marrë edhe vëmendjen ndërkombëtare. Pas shqyrtimit paraprak të këtij propozim-vendimi nga ana e Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Kuvendi i Republikës së Kosovës me 92 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, autorizon dërgimin e kontingjentit të FSK-së në misionet e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse në regjionin e Komandës Qendrore Amerikane–U.S. Central Command (USCENTCOM). Sipas ftesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kontingjenti i FSK-së do t'i bashkohet Gardës Kombëtare të IOWA-s, në misionin e parë paqeruajtës ndërkombëtar. Në fjalën e tij, në seancën e Kuvendit të Republikës së Kosovës Ministri i Mbrojtjes z Anton Quni, ndër të tjera theksoi: „Është një moment shumë i veçantë për Kosovën, që përveç një mundësie historike ku FSK-ja radhitet përkrah SHBA-ve dhe partnerëve strategjikë për të kontribuar në paqen dhe sigurinë në nivel ndërkombëtar; njëkohësisht është edhe një reflektim që të shohim prapa dhe të shprehim falënderimin dhe mirënjohjen e lartë për mbështetjen e pakursyer nga të gjithë partnerët tanë, të cilët arritën në Kosovë, 20 vjet përpara, me të njëjtin mision, për të vendosur dhe ruajtur paqen dhe sigurinë në Kosovë". Pjesëmarrja e FSK-së në misione paqeruajtëse jashtë vendit po bën historinë më të re të Kosovës, duke konfirmuar se Kosova mbetet e përkushtuar për t'i kontribuar paqes dhe sigurisë botërore, përkrah partnerit strategjik Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe partnerëve dhe aleatëve të tjerë në rrugën drejt integrimeve euro-atlantike.

FSK-ja i bashkohet Gardës Kombëtare amerikane në misionin e parë ndërkombëtar paqeruajtës



Prishtinë, 01 janar 2021. Me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Vendimin për bashkëdërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë të Kosovës në misionin e parë paqeruajtës, jashtë vendit, si pjesë e Gardës Kombëtare të Iowa-s, sipas ftesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kontingjenti i FSK-së do të jetë pjesë e misionit në mbështetje të stabilitet rajonal në operacionet paqeruajtëse në regjionin e Komandës Qendrore Amerikane–U.S. Central Command (USCENTCOM). Krahas përkushtimit të vazhdueshëm për të avancuar aftësitë dhe kapacitetet operacionale, FSK-ja po arrin suksese të mëdha edhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke fuqizuar në vazhdimësi subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Besimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ta përfshijë FSK-në në misione ndërkombëtare paqeruajtëse, konfirmon edhe njëherë përkrahjen për Kosovën, duke e konsideruar si një faktor të rëndësishëm në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon e kudo në Botë. Kosova mbetet e përkushtuar për bashkëpunimin me SHBA-të dhe partnerët strategjikë në orientimet e saj euroatlantike.

Në bazën Camp Dodge në Johnston të Iowa-s

Ushtarët e FSK-së hynë në histori për ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore



SHBA-25 janar 2021. Në një ceremoni ushtarake, në prezencën e autoriteteve civile dhe ushtarake, në bazën Camp dodge në Johnston, të shtetit të Iowa-s, është realizuar ceremonia para zbarkimit të grupit të parë 734 Regional Support Group të Gardës Kombëtare të IOWA-s, pjesë e të cilit në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare do të jenë edhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Me këtë rast, në emër të Republikës së Kosovës, MM/FSK-së, kolonel Ilir Qeriqi, atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e Kosovës në SHBA, iu drejtua me një fjalë rasti ushtarëve të rreshtuar në këtë ceremoni, duke lexuar edhe letrën e dërguar nga KOMFSK gjenerallejtënant Rahman Rama. „Partneriteti disavjeçar ka arritur pikën më të lartë të bashkëpunimit; si një mundësi unike e moment historik për FSK-në, për të kontribuar në misione paqeruajtëse përkrah ushtrisë amerikane. Ai ka shprehur mirënjohje ndaj ushtrisë amerikane për partneritetin strategjik dhe mbështetjen e saj në zhvillimin e kapaciteteve të FSK-së. Senatorja amerikane znj Joni Ernst dhe gjenerali Corell, komandant i Gardës Kombëtare të Iowa-s, e kanë cilësuar si një moment historik dukje e vlerësuar lart bashkëpunimin disavjeçar ndërmjet Gardës Kombëtare të Iowa-s dhe FSK-së. I pranishëm në ceremoni ishte edhe z Artan Duraku, konsull i përgjithshëm në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Iowa. Republika e Kosovës i është shumë mirënjohëse ushtrisë amerikane, përkatësisht Gardës Kombëtare të Iowa-s për mbështetjen e vazhdueshme dhe mundësinë historike që i ka dhënë FSK-së për t'i kontribuar paqes dhe sigurisë botërore.

Kryeministri Hoti dhe Ministri i Mbrojtjes Quni përgëzojnë FSK-në për pjesëmarrje në misione paqeruajtëse ndërkombëtare



Prishtinë, 06 janar 2021. Në kazermën „Adem Jashari“ të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), për vizitë zyrtare ishte kryeministri i Kosovës Abdullah Hoti, ku së bashku me zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj, ministrin e Mbrojtjes z. Anton Quni, komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, drejtorin e NALT-it gjeneral Frank Best dhe stafin e lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, iu adresuan oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve, pas miratimit nga deputetet e Kuvendit të Kosovës të vendimit për pjesëmarrjen e FSK-së në misione paqeruajtëse ndërkombëtare në kuadër të ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), përkatësisht Gardës Kombëtare të Iowa-s. Kryeministri Hoti, para ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së dhe stafit të lartë të Ministrisë të Mbrojtjes, veç tjerash tha: „Një fillim i mbar i vitit me këtë vendim. Për vendime të tilla duhet distancë e caktuar kohore për të rezonuar dhe kuptuar plotësisht se sa të rëndësishme janë. Vendimin që e mori Kuvendi i Kosovës, është ndër hapat më të mëdhenj historik që kemi bërë si shtet dhe si FSK, drejt integrimit të plotë të FSK-së në strukturat euroatlantike. Si Ministër i Mbrojtjes, ndjehem i privilegjuar që të ndaj emocionin e ngjarjes më të madhe që nga legjitimimi i mandatit ushtarak të FSK-së para dy vjetësh. Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit është vendim historik“. Ministri Quni, me këtë rast, ka vlerësuar përkushtimin dhe profesionalizimin e të gjithë pjesëtarëve të FSK-së, i cili ka rezultuar me këtë sukses të jashtëzakonshëm: „Ju, me rezultatet e jashtëzakonshme të arritura në qendrat dhe institutet profesionale, akademitë ushtarake e kolegjet e luftës, keni dëshmuar nivel të lartë të kulturës e dijes akademike ushtarake para aleatëve tanë si garanci e fuqishme se dini dhe mund të realizoni detyra planifikuese shtabore, si dhe ato të komandimit e drejtimit strategjik të forcave e njësive operacionale“. Në fund, ministri Quni, me theks të veçantë ka falënderuar bashkëpunimin e ngushtë dhe të shumanshëm me SHBA-në. „Besimi i SHBA-së, aleatit tonë të natyrshëm e shton edhe më shumë vlerën e kësaj të arriture historike. Ne me forcat amerikane jemi ndjerë gjithmonë NJË. Tani me forcat amerikane, përveç zemrave e mendjeve do t‘i kemi NJË edhe trupat e armët tona në misionet e shenjta në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit për mbarë njerëzimin. Ky është misioni ynë drejt përmbushjes së vizonit tonë për integrimin në NATO, respektivisht familjen euroatlantike, aty ku kemi qenë historikisht me qenien e identitetin tonë mijëvjeçar“. Ai e përmbylli fjalën e tij, me urimin: „Urime e na priftë e mbara në sukseset tona të reja“!



Nënshkruhet plani bilateral në fushën e mbrojtjes mes Kosovës dhe Italisë

Romë, 18 shkurt 2021. Pas një pune të përbashkët mes dy delegacioneve, në Shtabin e Përgjithshëm të Mbrojtjes të Republikës së Italisë në Romë, për herë të parë, u nënshkrua plani bilateral në fushën e mbrojtjes mes ministrive të mbrojtjes së Kosovës dhe Italisë. Me protokoll zyrtar, nënshkrimi i planit bilateral u bë nga drejtori i departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrime Euroatlantike (DBNIE), kolonel Hasan Hoxha në emër të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe kolonel David Morpurgo nga



shtabi i Përgjithshëm i Mbrojtjes së Republikës së Italisë. Plani bilateral përmban aktivitetet kryesore të fushës së mbrojtjes të cilat do të realizohen në mes Forcave të Armatosura të Republikës së Italisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi në të ardhmen të zgjerohet e intensifikohet edhe më tej. Pjesë e delegacionit nga Kosova ishin edhe shefi i Departamentit të Planifikimit dhe Financave në SHPFSK, kolonel Agron Bajrami, shef i Departamentit për Operacione dhe Trajnim në SHPFSK, kolonel Ejup Maqedonci, dhe znj. Edona Abazi Zylfijaj, zyrtare e DBNIE-së. Nga pala italiane në bisedimet ishte prezent edhe kom. Miretti, nga Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes së Republikës së Italisë. Delegacioni ynë, në Romë, u pritën edhe në ambasadën e Republikës së Kosovës në Itali, nga ana e ambasadores Lendita Haxhitasim. Ajo u njoftua nga ana e delegacionit tonë për planin bilateral të nënshkruara. Nga ana e saj, ambasadorja Haxhitasim premtoi mbështetjen e saj në funksion të realizimit sa më efektiv të planit përkatës si dhe angazhimin e saj në forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit në mes dy ministrive dhe forcave respektive.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës

Prishtinë, 04 shkurt 2021. Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovë. Marrëveshja u nënshkrua nga znj. Rozafa Ukimeraj, sekretare e përgjithshme e MM-së dhe Avni Ahmeti, drejtor ekzekutiv i Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Në aktin e nënshkrimit ishte i pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Marrëveshja e bashkëpunimit mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës ka



për qëllim zhvillimin e dy institucioneve përkatëse në fushën e hartografisë dhe gjeoinformimit. Bashkëpunimi ndërmjet dy palëve do të realizohet në mënyrë reciproke përmes trajnimeve profesionale dhe vizitave studentore, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve menaxhuese të MM-së dhe AKK-së. Sipas kësaj marrëveshjeje, obligimet e përbashkëta të dy institucioneve do të jenë: angazhimi për krijimin e projekteve afatshkurta dhe afatmesme në aspektin e hartografisë dhe gjeoinformacionit, si dhe ofrimi i hapësirave për krijimin e kushteve optimale për realizimin e aktiviteteve të bashkëpunimit.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma “Adem Jashari”, Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mod.rks-gov.net

Ministri Anton Quni priti ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Nicholas Abbott

Prishtinë, 04 shkurt 2021. Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni, priti ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë z. Nicholas Abbott. Duke i uruar mirëseardhje, ministri Quni shprehu falënderimin për Mbretërinë e Bashkuar në mbështetjen e ofruar deri më tani në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e gjithmbarshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ministri Quni theksoi se mbështetja e deritashme e Mbretërisë së Bashkuar në fushën e arsimimit dhe stërvitjes si dhe në forma të tjera ka qenë shumë e rëndësishme për ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e kuadrove profesionale në realizimin e aftësive



dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s, siç është edhe vet Mbretëria e Bashkuar. Ministri Quni e njoftoi ambasadorin Abbott edhe me procesin e implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, respektivisht procesin e rekrutimit të stafit ushtarak dhe civil të MM-së dhe FSK-së duke ritheksuar se ky proces është duke u realizuar në transparencë të plotë dhe në monitorim edhe nga organizatat tjera të besueshme. Ai shprehu interesimin për mbështetjen profesionale edhe të ekspertëve britanikë për procese përkatëse për të avancuar edhe më tej Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në institucione efektive me vlera dhe standarde të vendeve të NATO-s. Nga ana e tij, ambasadori Abbott, premtoi se Mbretëria e Bashkuar, sikur edhe deri më tash, do të vazhdojë partneritetin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, në mënyrë që të përmbushë me sukses të plotë objektivat e përcaktuar, respektivisht procesin e tranzicionit sipas planit përkatës. Në fund të takimit, ministri Quni dhe ambasadori Abbotti dolën me një qëndrim të përbashkët, që të intensifikohet edhe më tej bashkëpunimi dypalësh mes dy vendeve mike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja përmbyllen me sukses vitin e dytë të tranzicionit

Prishtinë, 21 janar 2021. Në kazermën „Adem Jashari“ u organizua ceremonia e përmbylljes së vitit të dytë të tranzicionit të FSK-së. Në këtë ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, drejtori i NALT-it, gjenerali Frank Best, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësues të NALT-it, atashe dhe këshilltarë ushtarakë ndërkombëtarë.

Në fjalën e tij, ministri Quni, pasi i përshëndeti të pranishmit dhe i uroi për sukseset e arritura gjatë realizimit të planit dyvjeçar të tranzicionit të FSK-së, tha: „Sot shënojmë 2-vjetorin e lansimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, andaj ndjehem krenar dhe i privilegjuar, që kemi arritur që



të realizojmë pjesën më të madhe të aktiviteteve për këtë periudhë planifikuese, e në disa fusha edhe t'i tejkalojmë ato“. Më tej, ministri Quni, shtoi: „Krahas këtyre sukseseve, brenda kësaj periudhe kemi avancuar sistemin e hartimit dhe zbatimit të politikave të mbrojtjes në fushën e planifikimit, programimit, modernizimit e standardizimit të forcave, bashkëpunimit ndërkombëtar e integrimeve euroatlantike, inteligjencës dhe sigurisë, sistemit të integruar të burimeve materiale, infrastrukturore e mbështetjes logjistike“. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij tha: „Kjo ditë shënon kalimin nga një fazë administrative, doktrinare dhe konceptuale në një fazë të ndërtimit të aftësive teknike, taktike dhe luftarake në nivel të njësive operacionale. Konsideroj, që, pa marrë parasysh sfidat me të cilat jemi përballë, si: tërmeti në Shqipëri; pandemia globale; përmbytjet dhe shkurtimet e vazhdueshme buxhetore, kemi arritur që jo vetëm të përmbushim detyrat e parapara në këtë fazë, por edhe të tejkalojmë pritshmërinë tona“. Ndërsa, drejtori i NALT-it, gjenerali Best, përgëzoi Ministrinë dhe FSK-në. „Ju përgëzoj për atë që është arritur deri më tani. Veçanërisht ju përgëzoj për qasjen tuaj transparente, angazhimin tuaj për mbikëqyrje civile, qasjen tuaj shumetnike dhe theksin mbi drejtësinë dhe sundimin e ligjit. Ishte një nder dhe gëzim për të gjithë ne, në NALT, t'ju ndihmojmë dhe t'ju këshillojmë mbi hapat e ndërmarrë me të gjitha mjetet dhe aftësitë që kemi në dispozicion. NALT-i do të vazhdojë të jetë në krahun tuaj. Ne do të qëndrojmë të përkushtuar ndaj mandatit tonë; për këshilla, për krijimin e aleancave dhe për trajnime". Ceremonia u përmbyll me nënshkrimin e dokumenteve doktrinare nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, të cilat janë bazë për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Takimi virtual me përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes së Italisë

Prishtinë, 20 janar 2021. Bazuar në marrëveshjen dypalëshe të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes (atëherë MFSK) të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikë së Italisë, të vitit 2018, e cila specifikon çështjet fondamentale të bashkëpunimit bilateral, dhe në vazhdën e thellimit dhe avancimit të bashkëpunimit dypalësh, u zhvillua takim zyrtar virtual mes dy delegacioneve, ati të Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes të Italisë. Kolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe



Integrime Euro-Atlantike (DB-NIEA) i Ministrisë së Mbrojtjes, kryesoi delegacionin e MM dhe Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së (SHPFSK), ndërsa delegacionin italian e kryesoi koloneli David Morpurgo, shef i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes të Republikës së Italisë. Në takimin e parë koordinues për këtë vit, u bisedua rreth avancimit dhe intensifikimit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet Kosovës dhe Italisë, me theks të veçantë identifikimin, konkretizimin dhe formatizimin e aktiviteteve të cilat do të mund të realizohen gjatë vitit 2021. Në takimin virtual të dy delegacioneve u diskutua edhe rreth draft Planit Bilateral Vjetor, për vitin 2021, për të cilin do të ketë koordinim dhe diskutime edhe gjatë javëve në vazhdim, deri, edhe kur pritet që ky Plan të nënshkruhet mes dy palëve në të ardhmen. Në takimin e sotëm bilateral, mori pjesë edhe atasheu italian në Maqedoninë e Veriut i akredituar për Republikën e Kosovës, kolonel Giuseppe Montalto dhe nga MM dhe FSK morën pjesë shefi i G3/7 i Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, kolonel Ejup Maqedonci, koloneli Alessio Gronchi, këshilltar bilateral në Ministrinë e Mbrojtjes, nënkolonel Remzie Zeqiraj, shefe e Sektorit Bilateral/Multilateral, major Blerand Hasanaj, oficer për bashkëpunim ushtarak ndërkombëtar dhe zyrtarja për bashkëpunim bilateral, znj. Edona Abazi - Zylfijaj. Në fund të takimit, të dyja palët u zotuan për vazhdimin e bashkëpunimit dhe thellimin e marrëdhënieve bilaterale në fushën e mbrojtjes edhe në të ardhmen.

Në Kazermën „Adem Jashari“

FSK-ja me ceremoni ushtarake shënoi



Prishtinë, 17 shkurt 2021. Në kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së në Prishtinë, sot u shënua me ceremoni ushtarake manifestimi qendror i shënimit të 13-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Në ceremoni morën pjesë: UD. e presidentit, znj. Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë z. Abdullah Hoti, ministri në detyrë i Mbrojtjes z. Anton Quni, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarja e përgjithshme e MM-së znj. Rozafa Ukimeraj, përfaqësues të familjeve Jashari dhe Rugova, zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Mbrojtjes, ambasadorë të QUINT-it, atashe të korit diplomatik, këshilltarë të NALT-it, ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të FSK-së.

U.D. e presidentit znj. Vjosa Osmani, pasi përshëndeti të pranishmit tha: „Pavarësia e vendit nuk do të arrihej pa rezistencën qytetare të prirë nga presidenti Ibrahim Rugova, pa sakrificën sublime të djemve dhe vajzave të UÇK-së dhe komandantit Adem Jasharit me familje, por edhe të heronjve e dëshmorëve të tjerë të vendit, pa të cilët, liria do të mbetej vetëm ëndërr! Kjo nuk do të ishte e mundshme as pa kontributin e të gjithë qytetarëve të



Ministri dhe komandanti i FSK-së homazhe në 13-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës në Prekaz

Prishtinë, 17 shkurt 2021. Në 13- vjetorin e shpalljes së Pavarësisë të Kosovës, në mjediset e Qeverisë së Kosovës, u bë ngritja e Flamurit shtetëror nga Garda Ceremoniale e FSK-së. Në ceremoni të pranishëm ishin U.D e presidentit znj. Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë z. Avdullah Hoti, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ministra në detyrë, zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Në orën 09:00, në Velani, u bënë homazhe dhe u vendosen kurora me lule te varri i Presidentit historik, Ibrahim Rugova, nga kryeministri në detyrë z. Avdullah Hoti, zv. kryeministri në detyrë Driton Selmanaj, ministri në detyrë i Mbrojtjes z. Anton Quni dhe ministra tjerë të kabinetit qeveritar. Po sot, rreth orës 10.00, ministri në detyrë i Mbrojtjes z. Anton Quni, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarja e përgjithshme Rozafa Ukimeri, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së, vizituan Kompleksin Memorial „Adem Jashari“ në Prekaz, ku bënë homazhe dhe vendosen kurora me lule në 13- vjetorin e shpalljes së Pavarësisë.



Në Kazermën „Adem Jashari“

i 13-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës





Kosovës, ngase secili nga ta bëri diçka për ta vendosur një gur në projektin e pavarësisë së vendit! Ata guxuan, prandaj fituan”! Ajo pati edhe një falënderim të veçantë për aleatët të cilët ndihmuan në çlirimin e Kosovës. “U jemi përjetë mirënjohës NATO-s, SHBA-ve dhe Evropës, ngaqë pavarësia e vendit nuk mund të imagjinohej pa ndihmën e tyre”. Në fund, UD. e presidentit znj. Osmani shprehi synimet e FSK-së dhe shtetit të Kosovës: “Forca e Sigurisë e Kosovës është ushtria më e re në botë dhe po kalon nëpër periudhën e tranzicionit 10-vjeçar. Por, gjatë gjithë kësaj kohe, FSK-ja krahas ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të veta, po punon edhe për realizimin e synimit strategjik të anëtarësimit në NATO. Shpresojmë dhe besojmë që në një të ardhme të afërt, ushtarët tanë do të jenë krahas atyre të NA-TO-s, kudo ku ka nevojë për ta mbrojtur paqen globale! Synim i vendit tonë është integrimi në bashkësinë e popujve evropianë”. Ndërsa, në fjalën e tij, kryeministri në detyrë z. Abdullah Hoti, tha: „Përvjetorët janë momente të veçanta, për të kujtuar ata që sakrifikuan çdo gjë për realizimin e aspiratës shekullore për liri dhe pavarësi. Sot me shumë mirënjohje përkulemi para kontributit të të gjithë atyre që udhëhoqën rezistencën paqësore dhe ushtarake dhe para gjakut të dëshmorëve“. Më tej, kryeministri në detyrë z. Hoti shtoi se: “Ditët si këto, na sjellin në vëmendje vlerat më të larta të atdhedashurisë, që jetojnë në përjetësi. Ndërkohë, në ditët si këto ne marrim fuqinë dhe përkushtohemi për borxhin që iu kemi fëmijëve tanë që Kosovën ta bëjmë një vend të realizimit të ëndrrave të çdo të riu, çdo prindi e çdo gjyshi, çdo mësuesi, çdo artisti, çdo bujku dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës“. Ai tha se ende mbetët shumë punë për të realizuar aspiratën për integrime euroatlantike. „Edhe në këtë përvjetor, kujtimi dhe mirënjohja për kontributin e pashembullt na bëhen udhërrëfyes që na jep forcë për të ngritur flamurin e Kosovës përkrah vendeve më të fuqishme për të garantuar paqen dhe sigurinë në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare“. Manifestimi qendror u përmbyll me ekzekutimin artistik të Orkestrës Frymore të FSK-së.



Pas vërshimeve kryeministri Hoti dhe ministri Quni vizitojnë fshatin Dobroshec të Drenasit



Prishtinë, 11 janar 2021. Kryeministri i Kosovës z. Abdullah Hoti së bashku me ministrin e Mbrojtjes z. Anton Quni dhe zëvendëskomandantin e FSK-së, gjeneral majorin Enver Cikaqi, vizituan fshatin Dobroshec të Komunës së Drenasit, pas reshjeve të vazhdueshme të shiut dhe vërshimeve të shtëpive, rrugëve dhe urave, me qëllim të përkrahjes së kësaj komune dhe qytetarëve të saj. Kryeministri Hoti, ministri Quni dhe gjeneral Cikqi, u njoftuan nga kryetari i Drenasit Ramiz Lladrovci për gjendjen aktuale në komunën e tij, pas përmbytjeve të ditëve të fundit. Ata më pas vizituan fshatin Dobroshec, ku pati dëme të konsiderueshme nga përmbytjet pas reshjeve të pandërprera. Pas situatës së krijuar në terren, FSK-ja e ka ngritur gjendjen e gatishmërisë dhe është duke realizuar operacione në disa zona në Kosovë, duke iu dal në ndihmë qytetarëve të vendit. Këto operacione do të vazhdojnë deri në normalizimin e situatës.



Në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK u mbajt trajnimi „Ndërtimi i Integritetit“



Prishtinë, 19 janar 2021. Në kuadër të bashkëpunimit mes Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, me organizim të Akademisë së Mbrojtjes, nga 12 deri 13 Janar 2021, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, është realizuar trajnimi „Ndërtimi i Integritetit”, me ligjërues të Institutit për Integritet në Fushën e Mbrojtjes. Për shkaqe të gjendjes së krijuar nga COVID-19, trajnimi është realizuar në formë virtuale (online). Qëllimi i trajnimit ishte ngritja e nivelit të integritetit për zyrtarët publikë, kryesisht për zyrtarë me pak ose aspak me përvojë në këtë fushë. Trajnimi ka mbuluar 5 fushat kryesore të rrezikut, si; Roli i fushave specifike (Financa, Prokurim, Burimet Njerëzore etj.; Praktikat më të mira të njohura ndërkombëtare; Pikat e mundshme të rrezikut ose dështimit; Rastet studimore që demonstrojnë ndikimin e dështimeve të sistemit dhe si mund të zbusim rreziqet. Trajnimin e kanë ndjekur 12 zyrtarë nga departamentet e MM-së dhe pjesëtarë të FSK-së, si nga Departamenti i Logjistikës, Departamenti i Prokurimit, Departamenti i Financave dhe Burimeve Njerëzore. Nga pjesëmarrësit, ky trajnimi u vlerësua si shumë i dobishëm për ngritjen e nivelit të integritetit të zyrtarëve në MM dhe FSK.

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës



Prishtinë, 12 shkurt 2021. Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Marrëveshja u nënshkrua nga znj. Rozafa Ukimeraj, sekretare e përgjithshme e MM-së dhe Ilir Berisha, zëvendësues i kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Marrëveshja e bashkëpunimit mes MM-së dhe ASK-së, ka për qëllim zhvillimin e bashkëpunimit institucional mes dy palëve; me qëllim të lehtësimit të proceduarave në ofrimin e të dhënave statistikore për MM nga ASK-ja, si dhe ofrimin e ndërsjellë të trajnimeve, mbështetja në organizimin e aktiviteteve, si dhe pjesëmarrja në aktivitet e përbashkëta. Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës në bazë të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të krijojnë lehtësira administrative për bashkëpunim institucional ndërmjet palëve duke përcaktuar fushat dhe detyrimet përkatëse të cilat janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Ceremoni me rastin e pensionimit të gjeneral majorZymer Halimit



Prishtinë, 15 janar 2021. Në Ministrinë e Mbrojtjes u organizua ceremonia për përcjelljen në pension të gjeneralmajorit Zymer Halimi, këshilltar i Presidentit të Republikës së Kosovës. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë: ministri i Mbrojtjes Anton Quni; zv. Ministri Muhamedali Mërgja; komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama; drejtori i NALT-it gjeneral Frank Best; gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së; zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes; përfaqësues të NALT-it; atashe dhe këshilltarë ushtarakë ndërkombëtarë; si dhe bashkëpunëtorë, miq dhe familjarë të gjeneral Halimit. Në fjalën përshëndetëse të mbajtur me këtë rast, ministri Quni e vlerësoi lart angazhimin jetësor dhe kontributin e gjeneral Halimit në luftë dhe në paqe, duke nënvizuar profesionalizimin e tij, në ngritjen e kapaciteteve të ushtrisë së Kosovës-FSK-së. „Si një ushtarak me eksperiencë të mjaftueshme profesionale dhe i mishëruar me parimet, vlerat dhe standardet më të larta të ushtarakut bashkëkohor, ju përmbushët me sukses maksimal përgjegjësitë strategjike në detyrat udhëheqëse në Komandën e Forcave Tokësore, si dhe ato në nivel të udhëheqjes strategjike të operacioneve të FSK-së, dhe këshillëdhënies nga fusha e strategjisë dhe e mbrojtjes së Presidentit të Republikës së Kosovës“. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, njëherësh edhe bashkëluftëtar i gjeneral Halimit, e vlerësoi lart kontributin e gjeneral Halimit në luftën Çlirimtare të Kosovës dhe në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, dhe në veçanti nënvizoi kontributin e tij si këshilltar i Presidentit të Republikës së Kosovës në strukturimin e FSK-së në misionin e ri ushtarak. Ai, ndër të tjera në fjalën e tij, tha: „Këto momente janë ndjenja të veçanta dhe emocione të përziera me krenari. Kamë pasur nderin të punoj me gjeneral Besin (me këtë emër e kemi thirr gjithmonë) kohë të gjatë, mbi 20 vjet, që nga koha e luftës çlirimtare si bashkëluftëtar dhe më pas në ndërtimin e institucioneve tona të sigurisë. Këshillat e tij kanë qenë të vlefshme për mua dhe për zhvillimin e institucionit tonë. Ai po pensionohet në institucionin ku ka punuar me nder, me krenari dhe faqebardhë. Kontributi i tij në ndërtimin e FSK-së deri në ngritjen e ushtrisë ka qenë i jashtëzakonshëm. Të faleminderit gjeneral për shërbimin dhe kontributin që ke dhënë për institucionin dhe vendin”. Nga ana e tij, gjeneral majori Zymer Halimi falënderoi ministrin, komandantin si dhe tërë stafin e MM-së dhe FSK-së, për bashkëpunimin e ndërsjellë në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së. Ka qenë nder, privilegj dhe krenari shërbimi im në etapat më të rëndësishme të çlirimit, ndërtimit dhe zhvillimit të vendit tim. Na mësuan dhe na trasuan rrugën dëshmorët, heronjtë që ranë për të mos vdekur kurrë. Kaloj një kohë e gjatë e punës së përbashkët me shumicën nga ju prezent, edhe pse një punë, jo e lehtë, me shumë e shumë sfida dhe sakrifica. Po ashtu falë punës së përbashkët, mirëkuptimit të lidershipit, vartësve, stafit tim të ngushtë, personelit të Presidencës, bashkëpunimit me ekipet e NALT-it dhe ekipet tjera paraprake që na këshilluan në vazhdimësi si dhe falë përkrahjes së pakursyer të familjes, rrethit familjar, shokëve dhe miqve“. Gjeneral Halimi, më tej, tha: „FSK-ja tani ka arritur një standard të lartë të organizimit dhe funksionimit. Është institucioni më i vlerësuar vite me radhë dhe prinë si shembull për institucionet në vendin tonë. Unë dëshiroj që FSK-ja të vazhdoj punën dhe profesionalizmin e saj deri në përmbushjen e planeve dhe objektivave të saj“. Ministri i Mbrojtjes zoti Anton Quni gjeneral Halimit i ndau medaljen për „Shërbim të shquar“, ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama „Medaljen e karrierës“, për merita të veçanta dhe kontributin e dhënë gjatë shërbimit në FSK.

Aksioni vullnetar i dhurimit të gjakut në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK

Prishtinë, 25 janar 2021. Në Ministrinë e Mbrojtjes filloi aksioni humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut, për vitin 2021, i cili do të vazhdojë të realizohet për dy javë në të gjitha kazermat e FSK-së. Aksioni është organizuar nga Qendra Mjekësore e FSK-së së bashku me Regjimentin Mjekësor dhe në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës. Dhurimi vullnetar i gjakut në këtë kohë është më se i nevojshëm, duke parë nevojat e përditshme për



gjak të QKTGJK, por edhe mjaft sfiduese për shkak të gjendjes së rënduar nga pandemia Covid-19. Forca e Sigurisë e Kosovës është e angazhuar që përmes dhurimit vullnetar të gjakut t'u gjendet sa më afër qytetarëve që kanë nevojë. Në ditën e parë, aksionit vullnetar i janë përgjigjur një numër i madh i zyrtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe pjesëtarëve të FSK-së. Dhurimi vullnetar i gjakut, në kuadër të FSK-së, tashmë është bërë traditë, me moton; „një pikë gjak për shpëtimin e një jete".

FSK-ja pjesë e operacioneve të kërkim-shpëtimit pas vërshimeve në Kosovë



Prishtinë, 13 janar 2021. Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK), pas reshjeve të vazhdueshme të ditëve të fundit dhe vërshimeve në gjithë territorin e Kosovës, me njësitet e specializuara për reagim në kriza, ekipet e kërkim-shpëtimit dhe të xhenios, u doli në ndihmë qytetarëve dhe institucioneve shtetërore në përballimin e situatës, me fokus të veçantë në shpëtimin e jetës së njerëzve. Pas vërshimeve të para (06.01.2021), FSK-ja ka marrë masat për të vlerësuar situatën në terren, duke angazhuar Kompaninë për Operacione me Civil, në nivel vendi. Më 08.01.2021 janë pranuar kërkesat e para për mbështetje nga Komuna e Gjakovës, përmes Institucioneve Qeveritare për t'i mbështetur autoritetet civile, për zhvendosjen dhe strehimin e 55 qytetarëve në Aeroportin e Gjakovës. Në ditët në vazhdim, ekipet e kërkim - shpëtimit kanë intervenuar në fshatin Kuzmin të Fushë Kosovës, ku kanë shpëtuar 3 qytetarë të ngujuar në shtëpitë e tyre. Operacionet e FSK-së, kanë vazhduar edhe më 10, 11 e 12 janar, për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve dhe institucioneve në përballimin e situatës emergjente. FSK-ja i ka dalë në ndihmë Policisë së Kosovës, në pengimin e përmbytjes së objektit të Forenzikës së Policisë së Kosovës, ku janë angazhuar ekipet xheniere të Gardës Kombëtare, gjithashtu kanë intervenuar edhe në Klinikën e Pulmologjisë të QKUK-së, ku kanë penguar përmbytjen e objektit. Njësitet e kërkim-shpëtimit në ujëra, më 11.01.2021, gjatë ditës dhe natës kanë vepruar në rajonin e Drenasit, në fshatrat Poklek, Shtrubullovë e Komaran, ku kanë shpëtuar 43 qytetarë të ngujuar në shtëpitë e tyre. Ekipet e kërkim-shpëtimit, po këtë ditë, kanë shpëtuar dhe evakuuar 3 banorë të fshatit Volljak të Klinës. Më 12 janar, ekipet profesionale të FSK-së, kanë realizuar operacione të kërkim-shpëtimit edhe në Komunën e Fushë Kosovës, Vushtrrisë dhe Prizrenit, ku kanë shpëtuar dhe evakuuar 16 persona. FSK-ja është në gjendje gatishmërie 24 orë në 7 ditë të javës për të intervenuar me kapacitetet e saj operacionale, duke iu përgjigjur kërkesave që vijnë nga institucionet shtetërore. Vërshimet kanë shkatërruar edhe infrastrukturën rrugore, ku janë dëmtuar disa ura. FSK-ja me ekipet e xhenios, kanë bërë vlerësimin e urës së dëmtuar në fshatin Dobroshec të Drenasit dhe urës në fshatin Hajnoc të Kamenicës, me qellim të ngritjes së urave mobile të FSK-së për të mundësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve. Forca e Sigurisë e Kosovës është e përgatitur për t'iu dalë në ndihmë institucioneve të Kosovës, dhe të gjithë qytetarëve në raste emergjente si në: kërkim-shpëtim në ujëra; male dhe kërkim-shpëtim urban.















